

Jusuf BUXHOVI

MAQEDONIA

(Nga antika deri te koha jonë)

Botues:

*Ramiz Tafilaj*

*Nazmi Rrahmani*

Redaktor:

*Ramadan Musliu*

Jusuf BUXHOVI

# MAQEDONIA

(Nga antika deri te koha jonë)

“JalifatPublishing”Houston

“Faik Konica” Prishtinë

2019

3



# **PËRMBAJTJA**

## **HYRJE**

### **PJESA E PARË**

#### **ANTIKITETI**

#### **KAPITULLI I PARË**

##### **MAQEDONIA ANTIKE PJESË E BOTËS PELLAZGE-ILIRE**

Nga miti deri te historia, 17

Maqedonasit, Pajonët dhe Brygët (Frigjët), 20

Maqedonasit dhe Dardanët, 33

Maqedonasit, Epirotët dhe Helenët, 42

Mbretëria Maqedonase gjatë kohës së Filipit II, 56

Aleksandri i Madh dhe Perandoria Botërore, 60

Rikthimi i luftërave me Ilirët dhe Dardanët dhe luftërat kundër Romës,73

#### **KAPITULLI I DYTË**

##### **ILIRIKU DHE ROMA**

Pushtimet romake dhe kryengritjet ilire, 81

Maqedonasit, Dardanët dhe Ilirët gjatë Perandorisë romake, 90

Romanizimi dhe identiteti etnik ilir-dardan, 103

### **PJESA E DYTË**

#### **MESJETA**

#### **KAPITULLI I PARË**

##### **BIZANTI**

Iliriku dhe shfaqja e Bizantit, 119

Krishterimi në Dardani, Maqedoni dhe Ilirik, 136

Dardania, Maqedonia dhe Bizanti, 151

Ilirët në kuadër të mendësisë së hershme bizantine, 166

## **KAPITULLI DYTË**

### **SLLAVËT NË ILIRIK**

Dyndjet e Sllavëve dhe kriza e parë e Bizantit, 176  
Maqedonia dhe Dardania gjatë pushtimeve bullgare, 192  
Nga Themat deri te principatat e para të Arbnit 203

## **KAPITULLI I TRETË**

### **MIDIS BIZANTIT DHE PËRENDIMIT**

Kryqëzatat katolike drejt lindjes dhe pushtimet rasiene, 212  
Despotati i Epirit dhe “Mbretëria e Arbërisë”, 231  
Mbretëria e Arbërisë dhe pushtimet rasiene, 242  
Agonia e Bizantit dhe principatat e Arbnit, 264

## **PJESA E TRETË**

### **PËRANDORIA OSMANE**

## **KAPITULLI I PARË**

### **OSMANËT DHE BIZANTI**

Shfaqja e osmanëve në Ilirik, 287  
Fillimet e sovranitetit osman në Arbëri, 292  
Lufta e Dardanisë e vitit 1389 – midis realitetit dhe mitit, 298  
Rrënimi i principatave të Arbrit dhe sanxhaqet osmane, 310

## **KAPITULLI I DYTË**

### **GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU**

Kastriotët dhe Arbëria, 328  
Skënderbeu dhe fillimet e luftës kundër osmanëve, 336  
Skënderbeu dhe shtetit i bashkuar Arbëror, 340  
Skënderbeu dhe Perëndimi, 350  
Vdekja e Skënderbeut dhe fundi i fisnikërisë arbërore, 361

## **KAPITULLI I TRETË**

### **MIDIS LINDJES DHE PERËNDIMIT**

Në kërkim të lidhjes me qytetërimin perëndimor, 371  
Luftërat austro-osmane dhe roli i Shqiptarëve në to, 377  
Riti ortodoks dhe gjuha shqipe, 390

## **KAPITULLI I KATËRT**

### **REFORMAT E TANZIMATIT DHE PËRPJEKJET PËR MODERNIZIM**

Tanzimati dhe lëvizjet për pavarësi, 395  
Rebelimi i pashallarëve shqiptarë: Bushatlinjve dhe Ali Pashë Tpelenës, 401  
Autonomia e Serbisë, pavarësia e Greqisë dhe nxjerrja në pah  
e çështjes shqiptare, 411  
Kryengritja e Dervish Carës, 428  
Pansllavizmi dhe lëvizjet nacionale në Ballkan, 436

## **KAPITULLI I PESTË**

### **KRIZA LINDORE**

Lufta ruse-osmane, Shën Stefani dhe reagimet e Fuqive të Mëdha, 446  
Lidhja Shqiptare e Prizrenit, 442  
Kongresi i Berlinit 1878, 460  
Kongresi i Berlinit dhe çështja shqiptare, 470  
Vendi dhe rëndësia e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, 477  
Kriza e Maqedonisë, “Besëlidhja shqiptare” dhe “Lidhja e Pejës”, 483  
Programi politik i Rilindjes Kombëtare, 501

## **KAPITULLI I GJASHTË**

### **FUQITË E MËDHA DHE PARALOJA E LUFTËRAVE BALLKANIKE**

Kriza e Maqedonisë – skenar hegjemonist ruso-sllav, 514  
Kryengritja e “Ilindenit” dhe Republika e Krushevës, 530  
Kriza e Maqedonisë dhe ndërhyrja ndërkombëtare, 535

## **KAPITULLI I SHTATË**

### **XHONTURQIT DHE SHQIPTARËT**

Opsioni i rrëzimit të despotizmit me anën e revolucionit, 544  
“Komiteti i Manastirit” dhe lufta e armatosur, 555  
Shqiptarët dhe formimi i Komitetit “Bashkim dhe Përparim”, 567  
Revolucioni xhonturk dhe roli vendimtar i shqiptarëve në të, 572  
Fillimi i kryengritjes në Resnje dhe përfundimi i saj në Ferizaj  
me kthimin e Kushtetutës, 558  
Përputhjet dhe shpërputhjet midis Shqiptarëve dhe Xhonturqit, 596  
Kongresi i Alfabetit në Manastir dhe shqiptarizmi kulturor. 611

## **KAPITULLI I TETË**

### **PARLAMENTARIZMI I DYTË (1908-1912) DHE SHQIPTARËT**

Shqiptarizmi dinamik dhe konfliktet me  
centralizmin nacionalist osman, 621  
Rikthimi i fushatave ushtarake në Shqipëri  
dhe kryengritjet e viteve 1909-1911, 630  
Kryengritja e Kosovës e vitit 1912  
dhe marrëveshja e Shkupit me Osmanët, 653  
Luftërat ballkanike dhe shpallja e pavarësisë së Shqipërisë 674

## **PJESA E KATËRT**

### **COPËTIMI I SHQIPËRISË**

## **KAPITULLI I PARË**

### **KONFERENCA E LONDRËS**

Një Shqipëri e përgjysmuar dhe mbetja e Kosovës  
dhe e Maqedonisë nën pushtimin serb, 704  
Rezistenca e armatosur kundër pushtimit dhe ripushtimeve, 722  
Lëvizja kaçake dhe Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, 733



## **KAPITULLI I DYTË**

### **POLITIKA ANTSHQIPTARE E BEOGRADIT**

Fillimi i kolonizimit të viseve shqiptare, 767

Shpërnguljet e shqiptarëve për në Turqi, 771

Programet antishqiptare të akademikëve të Beogradi: Memorandumi i

Çubrilloviqit i vitit 1937,

“Xhemjeti” i Shkupit dhe përpjekjet për asimilimin e shqiptarëve nëpërmes islamizimit, 781

## **KAPITULLI I TRETË**

### **LUFTA E DYTË BOTËRORE DHE REALITETET E REJA**

Rrënimi i Jugosllavisë së Versajës dhe bashkim i përkohshëm shqiptar, 799

Realitetet e reja shqiptare dhe lidhja ideologjike me komunistët jugosllavë, 802

Përçarjet shqiptare mbi përkatësitë ideologjike dhe diktati jugosllav, 809

Lidhja e Dytë e Prizrenit dhe Shteti i Pavarur Shqiptar, 825

## **PJESA E PESTË**

### **RIKTHIMI I JUGOSLLAVISË**

## **KAPITULLI I PARË**

### **RIPUSHTIMI I KOSOVËS DHE MAQEDONISË**

Rezistenca kombëtare kundër partizanëve jugosllavë dhe shqiptarë, 835

Memorandumi i dytë i Çubrilloviqit dhe vazhdimi i politikës antishqiptare, 839

“Lëvizja Nacional Demokratike” (NDSH) e Shkupit dhe bashkimi kombëtar, 843

## **KAPITULLI I DYTË**

### **EPUBLIKA E MAQEDONISË DHE JUGOSLLAVIA**

Maqedonia krijesë politike e Titos, 853

Maqedonia në Federatën jugosllave - përfituesja kryesore, 886

Maqedonia dhe kthimi i saj në epiqendër të shpërnguljes së shqiptarëve për në Turqi, 872

Asimilimi i shqiptarëve ortodoksë në Maqedoni, 882  
Nga “populli punonjës” në komb shtetformues, 883  
Rënia e Rankoviqit në vitin 1966 dhe demonstratat  
e shqiptarëve në vitin 1968, 891  
Ndryshimet kushtetuese të viti 1974 dhe vrulli  
i emancipimit kombëtar i lidhur me Kosovën, 910

## **KAPITULLI I TRETË**

### **MAQEDONA DHE KOSOVA NË VITET 1981-1991**

Demonstratat e vitit 1981 dhe kthimi i politikës antishqiptare, 920  
Rikthimi i hakmarrjes ndaj Shqiptarëve, 929  
Maqedonia përkrah politikën e Millosheviqit  
për rrënimin e autonomisë së Kosovës nga ana e Beogradit, 936

## **KAPITULLI I KATËRT**

### **MAQEDONIA SHTET I PAVARUR 1991**

Shteti maqedonas i kthen shqiptarët në pakicë, 942  
Referendumi për autonomi dhe “Ilirida”, 946  
Raportet e Maqedonisë dhe Kosovës në prag të luftës në Kosovë, 954  
Raportet midis Maqedonisë dhe Shqipërisë, 956

## **KAPITULLI I PESTË**

### **MAQEDONIA DHE LUFTA E “USHTRISË ÇLIRIMTARE KOMBËTARE” E VITIT 2001**

Lufta për paqen e papërfunduar, 963  
Tri aspektet e luftës së UÇK-së: ushtarak, diplomatik dhe politik, 989  
Marrëveshja e Prizrenit – suksesin e luftës e ktheu në kompromis politik, 997

PËRFUNDIM, 1013

LITERATURA DHE BURIMET, 1020

REGJISHTRI I EMRAVE, 1047



## *HYRJE*

*Maqedoninë antike, si mbretëri ndër më të njohurat e kohës dhe Maqedoninë si shtet politik i krijuar në fund të shekullit njëzet, pos emrit dhe një takimi të vogël në një pjesë gjeografike, jashtë çfarëdo reference historike, i lidh vetëm prania e shqiptarëve, të cilët historikisht janë trashëgimtarë të maqedonasve antikë si pjesë e botës pellazge-ilire ku kishin shtratin e tyre të barabartë mbretëria e Maqedonisë dhe mbretëria e Dardanisë. Në këtë aspekt, Maqedonia shfaqet emër historik i shqiptarëve, njëjtë me Epirin, Dardaninë dhe Mbretërinë Ilire.*

*Ky qëndrim, megjithatë thyen stereotipat e deritanishëm rreth asaj se Maqedonia antike dhe maqedonasit ishin pjesë e Greqisë antike, pra grekë. Ndërsa përkatësia botës pellazge-ilire dhe mbretërive që kishte ajo, thyen edhe atë të çështjes së helenizmit si ekskluzivitet grek për faktin e pamohueshëm se e gjithë ajo që shfaqet si kulturë dhe qytetërim antik, nga miti e deri te filozofia, e ka shtratin te një qytetërim paraprak i njohur si pellazg, mbi të cilin u ngrit ai i mëvonshmi që iu atribuua atij grek. Kjo pranohet me të madhe dhe dëshmohet edhe nga autorët antikë dhe të mëvonshëm.*

*“Maqedonia nga antikiteti deri te koha jonë”, konceptualisht merret me thyerjen e këtyre tabuve. Pamja e Maqedonisë pjesë e botës pellazge-ilire, kundërshton stereotipin e gabuar të ekskluzivitetit të përkatësisë së helenizmit grek të krijuar nga filohelenizmi politik i shekullit XIX i ngritur asokohe nga intelektualë dhe shkencëtarë të njohur evropianë, të shumtën gjermanë dhe austriakë mbi konceptin e rikthimit të tij në sfondin e iluminizmit evropian. Ndaj, si e tillë, është shumë më afër të vërtetës historike, se mohimi ose përjashtimi i saj nga historiografia e manipuluar dhe e shtrembëruar ruse, greke, serbe, bullgare dhe të tjera për qëllime politike, që për pikënisje, jo rastësisht kanë Maqedoninë dhe Maqedonasit jashtë çdo lidhjeje me shqiptarët po edhe të përjashtimit të tyre nga historia.*

*Me këtë pretendim, po ashtu, shikohet edhe ngritja e çështjes së Maqedonisë, nga ajo gjeografike, që e kishte nga mesjeta e këndeje, te ajo politike, siç*

ndodhi me insistimin e Rosisë nga Kriza Lindore e këndeje, e cila kishte për qëllim që etnisë shqiptare të shpërndarë në katër vilajete (Shkodrës, Kosovës, Manastirit dhe të Janinës) ku ajo projektohej artificialisht me argumente fetare (krishterimi ortodoks), t'i rrënohej koncepti i vilajetit të përbashkët shqiptar në Perandorinë Osmane (një formë e Shqipërisë Osmane që do të kthehej në Shqipëri europiane në përputhje me rrethanat). E ashtuquajtura Republikë e Krushevës, që doli pas kryengritjes së "Ilindenit" në vitin 1903 dhe zhvillimet tjera të ndërmarra nga Serbia, Greqia dhe Bullgaria në vilajetet shqiptare, nga një çështje gjeografike të shkëputur dhunshëm nga konteksti historik, krijuan çështje politike në përputhje me projektet e tyre hegjemoniste ndaj një pike kyçe, ku ajo kishte epiqendrën historike dhe etnike. Si e tillë, në fillim të shekullit XX, Maqedonia u kthye në një poligon politik të interesave hegjemoniste serbe, greke dhe bullgare, që ushqeu krizat rajonale dhe ato botërore (luftërat ballkanike dhe atë të madhen botërore), nga të cila më së shumi përfitoi Jugosllavia e Titos dhe koncepti i ngritjes së saj në republikë të federatës jugosllave, me çka atë përfundimisht e nxori nga interesi bullgar dhe grek dhe interesat ruse, për ta kthyer në çështje jugosllave, së cilës i duhej edhe krijimi i kombit politik maqedonas si dhe gjuha maqedonase me alfabet cirilik (nga Vuk Karaxhiqi), ndonëse nga pikëpamja filologjike – ruan karakteristikat e një dialekti të bullgarishtes.

Reinkarnimi i Maqedonisë antike në shtet politik të kombit maqedonas jashtë kriterëve historike, siç ndodhi në vitin 1991 pas shpërbërjes së Maqedonisë, nga aspekti i pragmatizmit politik evropian, sigurisht se me marrëveshjen politike midis Shkupit dhe Athinës rreth emërimit "Maqedoni e veriut", mund të marrë epilogun "pajtues" midis gjeografisë (në anën e Shkupit) dhe "trashëgimisë së përvetësuar historike" (në anën e Athinës), por kjo nuk do ta lirojë nga anatema se emërtimi "Maqedoni e Veriut" ishte pjesë e një projekti bullgaromadhi nga vitit 1906. Kjo, megjithatë, nuk ndryshon faktin se as kombet politike, siç është ai maqedonas, i mbështetur mbi një amallgam bullgar-sllav, i krijuar së voni, as përvetësimi i emërtimeve të shteteve nga ai i një mbretërie botërore siç ishte i Maqedonisë antik në një Maqedoni koniunkturale, nuk mund të ndryshojnë të vërtetat historike, siç janë ato se popullata sllavo-maqedonase e shkapërderdhur në pjesën e saj dhe atë të mbretërisë dardane nuk kanë qenë asnjëherë pjesë e këtyre mbretërive antike, siç nuk mund të mohojë as faktet historike dhe realitetet jetësore deri te ato bashkëkohore, që

kanë të bëjnë me shqiptarët - trashëgimtarë legjitim të Maqedonisë antike dhe të qytetërimit të saj, gjurmët e së cilës shfaqen dhe ruhen në kulturën e tyre.

Në këtë aspekt, libri “Maqedonia nga antikiteti deri te koha jonë”, duke u përqendruar te argumentet historike, ato politike dhe demografike, atë e trajton në kuadër të çështjes shqiptare, pa përjashtuar edhe faktorët tjerë në tërësinë e saj (sllavo-maqedonasit dhe të tjerët në përputhje me rolin dhe vendin e tyre në të), por pa u përfshi në polemika me faktet e sajuara ose të shtrembëruara nga shumë historianë serbë, bullgarë, rusë, grek, maqedonas dhe të tjerë, të cilët, faktet historike i trajtojnë të shkëputura nga tërësia dhe të shumtën në përputhje me realitetet politike paçka se ata janë në kundërshtim pikërisht me të vërtetën historike.

Me argumentet historike - Maqedonia antike paraqitet pjesë e etnisë dardane-ilire. Shfaqja e saj në shekullin V para erës së re si dhe ngritja në perandori botërore në shekullin IV nga Aleksandri i Madh, ruajnë karakterin e saj. E tillë pasqyrohet edhe gjatë kohës së Perandorisë së Romës dhe në atë të Bizantit. Në të nuk ka kurrfarë gjurmësh sllave nga shkaku i njohur botërisht se në Ilirik ata shfaqen diku pas shekullit VII të erës sonë, në kohën e perandorit të Bizantit, Heraklit, pra nëntë shekuj më vonë, prej nga, në shekujt IX dhe X, pasi ta kenë pranuar krishterimin, me formacionet e tyre fisnore, gjithnjë me tretmanin e “barbarëve” të cilëve ju lejohet organizimi autentik fisnor (fillimisht zhupanitë e më vonë despotatet), marrin pjesë në jetën shoqërore dhe politike të perandorisë. Në këtë zhvillim, gjithsesi se mbretëria e Bullgarisë dhe ngritja e saj në një faktor të rëndësishëm në shekujt IX-XI luan një rol të veçantë, që mund të thuhet se ka ndikuar rrethanat politike dhe shoqërore, po jo edhe ato etnike, në Ilirikun Qendror. Ky fakt nuk qe e mundur të përmbysesh as nga referencat e Maqedonisë gjeografike që u shfaqen në shekullin XIX si dhe përpjekjet, që ajo të lidhej me Bullgarinë e Borisit dhe të Samuilin për krijimin e Bullgarisë së Madhe siç vendosi Paqja e Shën Stefanit e marsit 1878. Si dhe, nuk qe në gjendje ta ndryshojë as propaganda e njohur Beogradit për identifikimin e saj me “Serbinë mesjetare”, paçka se me këto “argumente”, në vitin 1912, gjatë Luftërave Ballkanike, në emër “të çlirimit”, u pushtua nga ushtria serbe.

Argumenteve historike të parashtruara më sipër, ku vazhdimësia e mbretërisë maqedonase dhe asaj dardane edhe gjeografikisht kishin shtratin e tyre të përbashkët etnik në hapësirat e shtetit të sotëm maqedonas, mund t’u shtohen edhe ato politike, që kanë të bëjnë me periudhën e Perandorisë Osmane dhe

*fundin e saj, kur edhe do të shfaqen interesat e ndryshme të Fuqive të Mëdha në këto pjesë prej nga e ka edhe origjinën ngritja e saj në krizë të sajuar politike me synimin që të kthehet në pre të pretendimeve ruso-sllave në përputhje me programet hegjemoniste bullgare, serbe dhe greke, me ç'rast, edhe shqiptarët, të përfshirë në katër vilajete (të Kosovës, Shkodrës, Manastirit dhe të Janinës), do të shfaqen me kërkesën e tyre për një vilajet të përbashkët autonom në kuadër të Perandorisë Osmane, një si Shqipëri Osmane, në rrugë për t'u kthyer në Shqipëri europiane çastin që Perandoria Osmane do të merrte fund.*

*Në këtë aspekt, vilajeti i Kosovës, si më i madhi, kazatë e të cilat përfshinin pjesën më të madhe të asaj që shfaqej si hapësirë gjeografike e Maqedonisë tashmë "të Veriut" që i atribuohet shtetit politik maqedonas, paraqitet qendër e shqiptarizmit politik, që doli nga programi i Lidhja Shqiptare të Prizrenit, i qershorit të vitit 1878, me Shkupin qendër të vilajetit, prej nga do të drejtohet e gjithë lëvizja kombëtare e viteve 1908-1912, që sollën edhe deri te shpallja e shtetit shqiptar, më 28 nëntor 1912. Ngjashëm mund të thuhet edhe për vilajetin e Manastirit si dhe qendrën e saj Manastirin, ku nacionalizmi shqiptar kishte qendrën kulturore ku edhe u themelua alfabeti i gjuhës shqipe me shkronja latine.*

*Krahas argumenteve etnike dhe atyre politike, janë edhe ato demografike, që të drejtës historike ia krijojnë edhe legjitimitetin e të drejtës jetësore, me të cilat dëshmohet prania e pandërprerë e shqiptarëve në këto troje nga antikiteti, realitet ky që nuk mund të anashkalohet, e aq më pak të rrënohej dhunshëm, siç u veprua me gjenocide gjatë viteve 1912 dhe 1944-45 dhe me etnocide të vazhdueshme, qoftë edhe me shpërngulje me marrëveshje shtetërore me Turqinë, të viteve 1936 dhe 1953, të cilat, infrastrukturën e administratës ekzekutive e kishin në Shkup në kryeqytetin historik të shqiptarëve.*

PJESA E PARË

**ANTIQUITETI**





## KAPITULLI I PARË

### MAQEDONIA ANTIKE PJESË E BOTËS PELLAZGE-ILIRE

#### NGA MITI DERI TE HISTORIA

Maqedonasit dhe Maqedonia, në kuadër të botës pellazge-ilire, zënë një vend të veçantë si etni dhe si mbretëri. Maqedonasit dhe Maqedonia, po ashtu, zënë një vend të veçantë edhe në botën helene dhe helenizmin si qytetërim në përgjithësi, ngaqë në kohën e Aleksandërit të Madh, kur perandoria e tij arriti përmasat botërore, u kthye në një kulturë universale. Kështu, etnia maqedonase në njërën anë si pjesë e botës pellazge-ilire ku gjendet djepi i antikitetit dhe mbretëria maqedonase - bartëse e një koncepti dinamik shoqëror-politik ndër më të njohurit në botë, në tjetrën anë, hapin çështjet e raporteve historike ende gjithnjë të pasqaruar midis faktorit pellazg-ilir dhe atij helen, më vonë grek, si dhe helenizimit në kuadër të antikitetit. Në këtë aspekt roli i dyfishtë i Maqedonasve dhe i Maqedonisë, i parë jashtë kundërimeve të deritanishme - të nënvlerësimit të faktorit pellazg ose edhe të përjashtimit si dhe përvetësimit të njëanshëm nga ana e filohelenizmit të shekullit nëntëmbëdhjetë, duke e shkëputur nga vazhdimësia historike - krijon mundësi për një rishqyrtim të gjithanshëm të antikitetit brenda për brenda atyre që atë e kanë përcjellë si qytetërim po edhe si mendësi politike dhe shoqërore në fazat e thyerjeve të rëndësishme dhe të kthesave të mëdha çfarë ishin ato nëpër të cilat kaloi etnia maqedonase në kuadër të asaj pellazge-ilire, me theks të veçantë nëpërmes procesit të vazhdueshëm për dominim në kuadër të saj. Kjo ishte e natyrshme në ato rrethana në raport me Dardanët dhe Dardaninë si amëz e saj, e deri te ngritja në perandori botërore, që pashmangshëm nënkuptonte dominimin mbi konceptin helen të poliseve-shtete e deri te konfrontimi me monarkitë lindore, atë perse, e të tjera.

“Diferencim” i brendshëm i faktorit etnik maqedonas dhe ai i mbretërisë së Maqedonisë, si një parakusht i vlerësimit të tyre objektiv historik, gjithsesi kalon nëpërmes pamjes mitike të tyre, karakteristik për faktorët e gjithmbarshëm të antikitetit në fazat e hershme të zhvillimit kur të menduarit mitik dhe

mitologjia në përgjithësi shënojnë kapërcimin e njohur të filozofia, nëpër të cilën u zhvilluan proceset e mëvonshme kulturore dhe ato shoqërore dhe politike.

Te kjo pikë, edhe Maqedonasit i përcjell tradita e pashmangshme e lidhjeve me perënditë, në radhë të parë me ata parahelenikë, ku Zeusi pellazgjik është kudo, argument ky më tepër në dobi të qëndrimit për prejardhjen e tyre nga lashtësia pellazge. Kështu, Makedoni është bir i Zeusit dhe vëlla i Magnezit, ose vëlla i Eolit,<sup>1</sup> hero eponim i Maqedonisë, prej nga ka marrë emërtimin ajo. Sipas një varianti tjetër, Makedoni është bir i Lykonit, i cili ka qenë bir i Pellazgut,<sup>2</sup> gjë që ka ndikuar që të cilësohet “Lykoani ilir”.<sup>3</sup> Por, te disa autorë të vjetër antikë, për t’iu dhënë varianti helen, Maqedoni nxirret si biri i Osirisit – perëndi i Egjiptit të vjetër, i cili me vdekjen dhe me rilindjen e tij bëhet shpëtimtar që siguron jetën në botën përtej varrit. Këtu, ndërhyjnë edhe Diodori, i cili Macedonin e sheh vëlla të Anubisit, perëndi tjetër e Egjiptit, me një kokë çakalli dhe shoqëron të vdekurit në botën tjetër.<sup>4</sup>

Nëse pamja mitologjike Maqedonasit i lidh me mitet pellazge, prej nga, sipas autorëve antikë, Macedoni del hero eponim i Maqedonisë, Maqedonia prej nga shfaqet etnia e tyre dhe më vonë edhe dinastitë dhe mbretërit e saj në të. Hapësira e saj historike, del e prekshme diku në trekëndëshin midis Ilirëve në perëndim, Dardanëve në veriperëndim dhe Trakëve në lindje, shtrirje kjo që nga burimet antike ndryshon në përputhje me zhvillimet shoqërore dhe politike nëpër të cilat do të kalojë mbretëria maqedonase nga shfaqja e saj, diku në shekullin VII para erës sonë e deri të rënia, në mesin e shekullit II p.e.s., siç ndryshon edhe vetë përbërja e faktorëve etnikë, ndonëse nga e njëjta rrënjë, dhe roli i tyre në kuadër të saj. Te kjo çështje me interes të veçantë paraqitet si aspekti etnik (me shumë fise), por edhe ai i raporteve shoqërore dhe politike me Pajonët, Brygët (Frigjët), Dardanët, Ilirët, Epirotët dhe të tjerët nga bota pellazge-ilire, ku edhe duhet parë përkatësia e tyre si dhe raportet me helenët, para se ata të ngrihen në përmasat e perandorisë botërore.

Edhe këtu, autorët antikë, thuhet përherë e kanë fjalën kryesore dhe janë të pashmangshëm edhe përkundër kundërthënive dhe paqartësive të tjera me të cilat përcillen shënimet e tyre, të cilat jo rrallë kanë shërbyer dhe vazhdojnë të shërbejnë për vlerësime të ndryshme që shpesh dalin të panatyrshme për shkak

<sup>1</sup> Bell, Re: “Place-namens in Classical Mythology: Greece”, California 1989, faqe 169.

<sup>2</sup> Shih: Strabon, VII, 329, fr. 1; Hesiodë, fr 29; Etienne de Byzance, s.v., Μακεδονία; Diodore de Sicile; Elien, Nat. Des An, X,48.

<sup>3</sup> Grimal, P: “Dictionnaire de la mythologie grecque et romaine”, Paris, 1951, faqe 117.

<sup>4</sup> Po aty, faqe 273.

të qasjes së interpretimit të tyre. E përbashkët e tyre, megjithatë, është se hapësira e Maqedonisë, para se ajo të shfaqet me pamjen e një dinastie dhe më vonë mbretërie (nga shekulli VII deri te II para erës sonë) dhe kryesisht lidhet me depërtimin e dinastisë Argede,<sup>5</sup> ishte e banuar me fise të shumta, ndër të cilët përmenden Periyejt (në pjesën e poshtme të Olimpit), Botijejt, Eordejt (pranë Physkoi në Megdoni), Edonët (po ashtu në Megdoni), Almonët (në Almoni), e të tjerë, e ku përmenden edhe Pajonët e pandashëm nga Dardanët dhe Dardania, “që u është marrë pjesa përreth Akses deri te Pelea dhe Deti (Egje).<sup>6</sup> Gjithnjë sipas burimeve antike, hapësira ku do të ngrihet dinastia dhe mbretëria e Maqedonisë, përbëhej nga disa krahina të “shkapërderdhura”, ndër të cilat përmendej Megodnia, Pelagonia dhe Pajonia, si më e madhja, e cila më parë quhej *Emathia*. Për Pajoninë, si një etni të rëndësishme midis dardanëve dhe maqedonasve, Straboni thotë se banonin ilirët (Botijejt me prejardhje nga Kreta) e ku kishte edhe fise trake (Pirejt, Pajonë, Edonë dhe Bisaltët), dhe se emri i mirëfilltë i Maqedonisë lidhet me këtë emërtim.<sup>7</sup>

Ndryshe nga Straboni, Herodoti, në kuptimin e një ngjizjeje etnike prej nga shihet i themeluar shteti i Maqedonisë dhe pamja e saj antike e dominuar nga Maqedonasit, janë vëllezërit Temenidi: Perdika, Gauani dhe Aeropi, të cilët, nga malet Bermion vërshuan në pjesët e tjera dhe i nënshtruan fiset e atyshme, me ç’rast disa prej tyre lëshuan vendin dhe iu nënshtruan lëvizjeve të shumta.<sup>8</sup>

## MAQEDONASIT, PAJONËT DHE BRYGET (FRIGJËT)

Të dhënat e Strabonit rreth Maqedonisë, që doli nga depërtimet e vëllezërve Temenidi - themelues të dinastisë maqedonase, ndonëse flasin për nënshtrimin e disa fiseve që ai i quan “ilire, epirote dhe trake”, me ç’rast thuhet se “disa prej tyre morën ikën për në vende të tjera”,<sup>9</sup> megjithatë, mbetet e paqartë pamja etnike e mëtutjeshme e Maqedonisë, sidomos e fiseve të rëndësishme Pajonëve dhe Frigjëve (Brygëve), që vazhdojnë të jenë të pranishëm edhe në rrethanat e reja, ku edhe shihet përkufizimi i tyre i pashmangshëm me Dardanët

<sup>5</sup> Turkididi (Thucydides): “*Historiae*”, ed. H. S. Jones – J. E. Powell, Oxonii, 1942, II,99.

<sup>6</sup> Po aty.

<sup>7</sup> Strabon (Strabonis) : “*Geographica graeca cum versione reficta curantibus*” - C. Müllers et F. Dübner. Parisiis edit. Ambrosio Firmin Didot 1853, VII, frg. 11.

<sup>8</sup> Herodoti: “*Historiarum*”, VIII-IX, ed. H. R. Dietsch – H. Kalberger, Teurbner, 1926, f. 138.

<sup>9</sup> Po aty, f. 45.

dhe Dardaninë thuajse në të gjitha zhvillimet, që pak më vonë, nga aspekti shtetëror, do të kthehet edhe në pikëpjekje të Maqedonasve me Dardanët.

Por, shfaqja e Pajonëve si grupi më i fuqishëm etnik në rrethanat e ngritjes së mbretërisë maqedonase, që edhe më tutje do të vazhdojnë të jenë të pranishëm në vorbullën e ngjarjeve historike, me të drejtë, krahas shtrirjes së gjerë<sup>10</sup>, nxjerr dilemën e rolit të tyre në këto zhvillime për faktin se sipas autorëve antikë, ata ruajnë praninë e tyre në pjesën e epërme dhe veri-lindore,<sup>11</sup> edhe pse ata, në shekujt V-II p.e.s. kthehen në një poligon ndeshjeje midis Dardanëve veriorë dhe Maqedonasve jugorë.

Brygët, ndonëse nuk përmenden te Straboni dhe Turkididi, Herodoti i zë në gojë si një faktor “tepër luftarak”, që do të dëshmohej, në fillimet e shekullit V p.e.s. gjatë fushatës së Mardonit në luftimet kundër ushtrisë perse.<sup>12</sup> Ato që thotë Herodoti për fuqinë ushtarake të Brygëve, megjithatë, nuk kanë të bëjnë me kohën e mbretërisë së tyre (shekulli XIII-VIII), por jashtë saj, në pjesën e Maqedonisë, gjatë kohës kur mbretëria maqedonase po i forconte pozitat e veta në raport me Dardanët, Pajontë, Epirotët dhe të tjerët përreth.

Ky dhe “inserte” të ngjashme ngre me të drejtë çështjen e rolit që kishin këto dy etni në diferencimet e mëtutjeshme shoqërore dhe politike midis ilirëve dhe trakëve, gjegjësisht faktorit dardan, ku shihen përherë në të njëjtën hapësirë dhe raporteve në shekujt VII-V para erës sonë, kur u shfaq dinastia dhe mbretëria maqedonase, duke ia hapur rrugën një zhvillimi të ri historik ndër më dinamikët e kohës, me ç’rast ajo u ngrit në një perandori botërore.

Në përputhje me këtë kundrim, bie në sy se raportet e Maqedonasve me Pajonët dhe me Brygët (Frigjët), flasin për garën e njohur për fuqi (qoftë edhe si luftë e ndërsjellë) e faktorëve përbërës brenda llojit të njëjtë (pellazgo-ilirëve), fenomen ky i natyrshëm për dominim dhe mbizotërim, paçka se ajo ka prodhuar luftëra të vazhdueshme, ndër të cilat jo pa të drejtë edhe ajo e Trojës shihet sy “luftë midis fiseve pellazge”.<sup>13</sup>

Lufta midis fiseve pellazge në Trojë, po edhe gjetiu shihet edhe nga autorë të tjerë. Po qe se “klasifikohen” mirë pjesëmarrësit e kësaj lufte hipotetike në

---

<sup>10</sup> Sipas Appinit, Pajonët “janë një fis i madh pranë Istrit (Slloveni e sotme) dhe shtrihen për së gjati nga Japodët deri tek Dardanët. (Shih“*Illyrike*”, 8.)

<sup>11</sup> Polybios (*Historiai* - 23, 10, 4.) dhe Straboni (“*Geographica graeca versione reficta curantibus*”, 7, f. 38), mendojnë se Pajonët zotëronin bregdetin fushor maqedonas, dhese Pajonia dikur shtrihej deri në Pelagoni dhe Pieri.

<sup>12</sup> Herodoti: “*Historiarum*”, VIII-IX, ed. H. R. Dietsch – H. Kalberger, Teurbner, 1926, f. 45.

<sup>13</sup> Shih: Budimir Milan: “*O etničkim odnosu dardanaca prema ilirima*“, Beograd, 1952.

përputhje me të dhënat e autorëve antikë, në njëfarë mënyre, ajo del edhe te “Iliada dhe Odisea”,<sup>14</sup> siç vërehet edhe te “Eneida”.<sup>15</sup>

Në këtë aspekt, nxjerrja sado e përafërt në dritë e Pajonëve dhe e Brygëve (Frigjëve), për aq sa këtë e lejojnë të dhënat e autorëve antikë si dhe ato që mund të rikonstruktohen disi nga dëshmitë gjuhësore, arkeologjike dhe antropologjike, në njëfarë mënyre i ndihmon ndriçimit të botës iliro-trake si një trashëgimi e asaj e shtrirë në Ilirik dhe Azi të Vogël si dhe rrethanave shoqërore dhe politike që e faktorizuan shtetin maqedonas në raport me Dardanët, Ilirët në njërin anë dhe Helenët në anën tjetër, ku Pajonët, në shumë aspekte dalin fis dardan<sup>16</sup>, ndërsa Brygët (Frigjët) - një fuqi e dyfishtë: fillimisht si dinasti në një pjesë të Maqedonisë dhe në Ilirinë juglindore - si Brygë, dhe më vonë, pas luftës së Trojës, në Azi të Vogël, në Bithynisë - Frigj, ku themeluan shtetin e tyre, që njihet si njëra ndër mbretëritë e fuqishme të antikitetit, që i tha fund mbretërisë së njohur hitite,<sup>17</sup> por që si do të shihet edhe ajo nuk mbetet jashtë orbitës së botës pellazge-ilire, ndonëse për një kohë të gjatë u vlerësua e lidhur me popullatën sumere.

Pavarësisht zhvillimeve nëpër të cilat kaloi mbretëria maqedonase, sidomos ajo e Aleksandërit të Madh, që atë e vuri në binarët e perandorisë botërore, nga të dhënat e autorëve antikë, del se pamja etnike e Maqedonisë midis shekujve XII dhe VIII p.e.s., pra ajo që do t’i paraprijë shfaqjes së dinastisë dhe më vonë mbretërisë maqedonase, fuqia e së cilës do të arrijë kulmin në shekullin IV p.e.s., dominohej nga Brygët në pjesën Perëndimore,<sup>18</sup> Pajonët në pjesën Qendrore<sup>19</sup> dhe Edonët (Migdonët) në pjesën Lindore të Egjeut.<sup>20</sup>

Pamja dominuese e këtyre grupeve etnike (Pajonëve dhe Brygëve), në hapësirën e përbashkët me përjashtim të Migdonëve, të lidhur me Brygët,<sup>21</sup> të

---

<sup>14</sup> Homer: “Iliada dhe Odiseja”, Tiranë, 1986.

<sup>15</sup> Virgilius Maro: “Eneis”, Heidelberg, 2006.

<sup>16</sup> Shih: Hahn, J. von G: “Albanesische Studien” m I, Jena 1854.

<sup>17</sup> Shih: Frashëri, Kristo: “Etnogjeneza e shqiptarëve”, Tiranë, 2013, faqe 98-104.

<sup>18</sup> Папазоглу, Фанула: “Етничка структура античке Македоније у светлости новијих ономастичких истраживања”, Balcanica, VIII, Belgrade, 1977, faqe 67.

<sup>19</sup> Sipas Polibit dhe Strabonit, Pajonët zotëronin bregdetin fushor maqedonas. Ata shtojnë se Pajonia dikur shtrihej deri në Pelagoni dhe Pieri. Kjo gjendje i referohet kohës së paraluftës së Trojës, sepse në Katalogun Trojan lumi i Aks(ios)it ka qenë kufiri perëndimor i viseve ku banonin Pajonët. (Spahiu, Arsim: “Maqedonia e vjetër dhe arkeologji e tyre”, Tiranë, 2013, faqe 34).

<sup>20</sup> Папазоглу, Фанула: “Етничка структура античке Македоније у светлости новијих ономастичких истраживања”, Balcanica, VIII, Belgrade, 1977, faqe 67.

<sup>21</sup> Në të shumtën e burimeve antike, Migdonët lidhen me Brygët (Frigjët). Në “Iliadë”, Migdon quhej prijësi i Brygëve (Frigjëve). Në “Iliadë” (III,186), Migdoni përmendet si hero oponim i fisit të Migdonëve. I vëllai, Edonos, ishte eponim i Edonëve, ndërsa i biri Grastos, eponim i fqinjëve, Krestosëve, ose Grestonëve. Sipas

shumtën del e paqartë sa nga raportet e tyre të brendshme shoqërore dhe politike që u pasqyruan në njërin anë me ngritjen e Brygëve në një mbretëri të fuqishme në shekullin XIII para e.s. e deri te rënia e tyre nga Cimerianët në shekullin VIII, me ç'rast jo rrallë thuhet se nuk ekziston ndonjë dallim etnik midis tyre, ngaqë paraqesin “një formë të hershme të shtresimit pellazg”,<sup>22</sup> të shkapërderdhur në pjesë të ndryshme në hapësirën euro-aziatike nga kushtëzimi i rrethanave (shpërnguljeve, luftërave dhe lëvizjeve të tjera të paqarta) dhe, në tjetrën anë, del e mjegulluar edhe nga vetë fuqia e njëmendë e asokohshme e këtyre etnive, kur dihet se Pajonët edhe më tutje mbesin një faktor i rëndësishëm midis pretendimeve të Dardanëve në pjesën qendrore të Ilirikut me Maqedonasit. Madje, në këtë aspekt, gjithnjë duke u mbështetur në të dhënat e autorëve antikë, mund të thuhet se Pajonët, gjatë një periudhe, në vitin 360 p.e.s. shkallmuan edhe mbretërinë e Maqedonisë,<sup>23</sup> por që do të jetë Filipi II, që sapo mori pushtetin, vuri paqe me Pajonët, por mbas vdekjes së mbretit të tyre Agassi në vitin 359, për pak i pushtoi,<sup>24</sup> por që edhe pas kësaj Pajonëtvazhdimisht do të kundërshtojnë Filipin II në aleancë me ilirët.<sup>25</sup>

Përkundër Pajonëve, prania e të cilëve vazhdimisht shihet në pjesën që ndanë Dardanët nga Maqedonasit (në veri të Maqedonisë), Brygët një tjetër etni e fuqishme e kohës, e shtrirë në hapësirën euro-aziatike, edhe “të fragmentuar”, paraprakisht identifikohen në pellgun e lumit Erigon (Εριγω), prej nga edhe do të largohen pasi u dëbuan nga Maqedonasit<sup>26</sup>, me ç'rast një pjesë e tyre u vendosën në Ilirinë jugore, në lindje të lumit Axios (Vardar i sotëm) dhe në pellgun e Korçës, ku ndodhet edhe vendbanimi i Maliqit,<sup>27</sup> por që më vonë si Frigj shfaqen edhe në Azinë e Vogël në kuadër të një mbretërie të fuqishme.

---

vajzave të tij është emëtuar edhe qyteti Parthenopolius, ndërsa sipas mbesës së Migdonit, Tirse, emërtohet qyteti Tirsai.

<sup>22</sup> Rreth shtresimit pellazg tek popujt indoevropian, që duhet patur parasysh jo vetëm në Ilirik dhe Anatoli, por edhe në gadishullin Apenin, tërheq vëmendjen, filologu jugosllav Millan Budimir në studimin e tij “*Pelasto-Slavica*”, 1951. Filologu i njohur, i cili mbron origjinën pellazge të Dardano-Ilirëve dhe Trakëve, që sipas tij jep shenja nga neoliti i hershëm, vlerëson se lidhjet e Pajonëve dhe të Brygëve me ato të Ilirëve të jugut dhe Liburnëve do të mund të sqaroheshin nëse kihet parasysh evoluimi nga ai shtresim i përbashkët, pra pellazg, pa përfshirë këtu edhe mundësitë e migrimëve të fiseve në hapësira të largëta. Budimir thotë se tradita rreth Pellagonëve dhe Brygëve në pjesën veriperëndimore të Adriatikut hyn në rrethin e këtyre çështjeve, të cilat nuk duhet parë si të gabuara.

<sup>23</sup> Shih Diodor: *Bibliotheca historica, recognovit*, Fr. Vogel, vepra, XVI,3,4, 1888.

<sup>24</sup> Po aty.

<sup>25</sup> Diodor, XVI,22,1 dhe Hammond, N.G.L.: “*A History of Macedonia*”, 1981.

<sup>26</sup> Georgief, V: “*La toponymie ancienne de la peninsule Balkanique et la These mediterraneene.*” Sofia 1961.

<sup>27</sup> Po aty.

Natyrisht se “ky ngatërrim” midis këtyre dy etnive dhe veçmas shfaqja e Brygëve si Frigj në Azi të Vogël në një rol dominues, që po ashtu, shihen edhe në pjesën e Maqedonisë, në afërsi thuajse të vazhdueshme të Dardanisë dhe në Ilirikun jugor, përcillet edhe me paqartësinë rreth fuqisë së njëmendtë të njëres apo tjetres etni në raporte të ndërsjella para, gjatë dhe pas shfaqjes së maqedonasve si fuqi në atë hapësirë, me ç’rast, për ndryshim nga Brygët që shihen si fis trak,<sup>28</sup> Pajonët merren edhe për fis dardan,<sup>29</sup> ndonjëherë edhe trakas,<sup>30</sup> po ku nuk mungojnë edhe vlerësimet nga ato se “Pajonët janë kolonë frygas”<sup>31</sup>, që më vonë “do të jenë asimiluar nga maqedonasit”?<sup>32</sup>

Por, në këtë kontekst, ka edhe një faktor tjetër domethënës, që “ngatërresës” pajone-bryge (frigje) i jep një sqarim në përputhje me rolin e faktorit dardan, nga shekulli XVI e këndeje, që del të jetë amëz e përbashkët e tyre, në rrethanat hipotetike të një mbretërie të fuqishme dardane nga kjo kohë, që është shtrirë në hapësirën euro-aziatike, e që rënia e saj në shekujt XIII-XII, pas ndonjë ndeshjeje midis fiseve pellazge për mbizotërim (e projektuar si luftë hipotetike e Trojës ndonëse dy-tre shekuj më vonë), është bartur te mbretëria Frigje. Se Dardanët paraqitnin një fuqi të madhe të kohës, kjo mund të kuptohet edhe nga mitologjia greke si dhe nga disa prej burimeve antike, që mund të jenë mbështetur mbi to. Fjala është për vendosjen e Dardanëve në Samothrakë (Skamandra), ishull ky në veri të detit Egje, që njëherësh paraqet portën e parë drejt Frigjisë (Azi të Vogël), ku ata themeluan qytetin Ilion (më vonë Trojë). Kjo lëvizje që del nga mitologjia greke dhe disa autorë antikë, ndër shumë sosh që përmenden nga mileniumi i dytë e këndeje nga pjesa e qytetërimit danubian drejt Lindjes (Europa Qendrore, Iliriku Perëndimor dhe Lindor), drejtpërdrejt i nxjerr Dardanët si aktorë të rëndësishëm historikë nga shekulli XVI para erës

---

<sup>28</sup> Herodoti flet për Bygët (Frigjetë) në tre vende. Në librin VI, faqe 45, i quan “fis trakas”. Por, në përshkrimin e popujve që kanë marrë pjesë në ushtrinë e Kserksit (libri VII, faqe 73 dhe 74), dallon Frigjet nga Trakët, të cilët sipas rrëfimeve të Maqedonasve, kur gjendeshin në Europë dhe gjendeshin në fqinjësi të Maqedonasve, quheshin “Brigjë”, ndërsa “kur kanë kaluar në Azi morën emrin Bitinjanë. Po ashtu, Herodoti, në librin VIII, faqe 185, duke i paraqitur ata që morën pjesë në ushtrinë e Kserksit nga Europa, përmend Trakët, Pajonët dhe Brygët, Pirejët, Maqedonasit e të tjerë. Edhe Straboni, në librin VII, faqe 25, përmend “fisin trakas Brygët”, të cilët më parë kanë jetuar në afërsi të maleve Bermion, një pjesë e tyre është shpërngulur në Azi, ku kanë marrë emrin Frigjët. Aty, po ashtu thuhet, se Grekët i merrnin Frigjet për trakas, që janë shpërngulur në Azi të vogël. Trakas konsideroheshin edhe Midonët dhe Bitinjanët.

<sup>29</sup> Hahn, Georg von: “*Albanensische Studie*”, Jena, 1865.

<sup>30</sup> Strabon, VII, 2, 3, 25.

<sup>31</sup> Këtë qëndrim e mbon V. Georgiev, duke iu bashkuar me gjuhëtarët e njohur ilirologë: Ed. Meyer, H. Krahe dhe të tjerë. (Shih: Georgiev, VI: “*La toponymie ancienne de la peninsule Balkanique et la These mediterraneene*”, Sofia 1961).

<sup>32</sup> Po aty.



sonë në një hapësirë aq të rëndësishme, siç ishte Samothraka, në veri të detit Egje, për të cilën Homeri thoshte se nga ai ishull mund të shihej fushëbeteja në Trojë.<sup>33</sup> Për këtë ishull W. Hazlitt thotë se Dardanët ishin ata që rreth vitit 1506 para erës sonë e populluan dhe pas asaj Azinë e Vogël:

“Dardani, një fis Pellazg nga Moesia ose Paeonia, nën udhëheqjen e prijësit të tyre Dardanus, djalit të Jupiterit dhe Elektrës, kolonizuan së pari Samothrakën dhe pastaj Dardaninë, në Azi të Vogël”.<sup>34</sup>

Se Samothraka në lashtësi është quajtur Dardani, Melitë etj., konfirmohet edhe nga A. Charles<sup>35</sup> dhe Laurent,<sup>36</sup> kjo është fare e mundshme. Mirëpo, njëfarë “paqartësie” që nuk duhej të ishte e tillë e shkakton e dhëna që haset jo rrallë ku Troja në të cilin u vendosën Dardanët në kohën sa sundohej nga mbeti Teuker (Teucer) dhe popullsia quhej sipas emrit të mbretit eukriane, por edhe Frigjia e Vogël.<sup>37</sup> Pas martesës së Dardanit me Batian, vajzën e mbretit Teuker, kur ai do të zëvendësojë në fron vjehrrin, popullsia do të quhej dardane. Edhe pse autorët antikë nuk e thonë, është fare afër mendsh se ndryshimi i emrit të popullit nga Teukrianë në Dardanë, nuk ka gjithaq të bëjë me martesën e Dardanit me të bijën e mbretit frigj, Teuker sa me atë se fjala ishte për etninë pellazge-dardane dhe shtrirjen e gjerë të saj edhe në atë pjesë, që jo rrallë u është nënshtruar herë emërtimeve gjeografike, e herë atyre të mbretërve, siç ka ndodhur me Ilirët në Iliri, me Trakët në Traki, Frigjët (Byget) në Frigji, Maqedonasit në Maqedoni e të tjera.

Shfaqja e faktorit dardan në këtë pjesë si dhe civilizimi që do të lulëzojë gjatë kësaj kohe (fjala është për shekullin XVI para erës sonë) me ç’rast kemi edhe ndërtimin e disa qyteteve me të njëjtin emër (*Dardanum* në breg të detit Marmara dhe *Dardana* pak më larg ku kishte edhe rezidencën),<sup>38</sup> krahas dukurisë së emërimit të etnive nga i njëjti trung etnogjuhësor me emërtime të ndryshme mbi bazat gjeografike dhe të dinastive mbretërore që u janë nënshtruar, qoftë edhe hipotetikusht, ngre çështjen e mundësisë së shtrirjes së gjerë

---

<sup>33</sup> Shih Homeri “*Iliada*”, Tiranë 1979. Kënga I, faqe 63.

<sup>34</sup> Shih: Hazlitt, William; “The Classical gazetteer: A Dictionary of Ancient Geografy, Sacred and Profane”, London: Whittaker and Co., 1851, faqe 132.

<sup>35</sup> Shih Athon, Charles: “*A System of Ancient and Mediaval Geography, For the Use Schools and Colleges*”, New York: Harper&Brothers, 1850, faqe 434, cituar sipas Laçej, Naim: “*Tanagra*”, Lezhë 2012, faqe 187.

<sup>36</sup> Shih: Laurent, Peter Edmund: “*An Introduction to the Study of Ancient Geography. With Copius Indexes*”, Oxford, For Henry Slatter: And Whitaker, Treacher, and Arnot, 1830, faqe 100.

<sup>37</sup> Shih Robinson, John: “*Ancient History; Exhibiting a Summary Views of Progres, Revolutiones, Delcine and Fall of dhe States and Nations of Antiquity*”, London 1831, faqe 162.

<sup>38</sup> Shih: Boog, G: “*The Historcal Library of Diodorus the Sicilian*”, London, 1814, faqe 285.

të mbretërisë dardane si shumë të fuqishme në të dy anët: në pjesën europiane dhe në pjesën aziatike. Fuqia e saj më së miri pasqyrohet me Frigjinë, ku edhe historikisht vërtetohet se Dardani sundoi në Frigji për 65 vjet dhe cilësohet mbret i Frigjisë,<sup>39</sup> në të cilën bënte pjesë edhe Troja, fakt ky që do t'i shtyjë disa autorë antikë (Herodotin, Strabonin dhe Plinin) që emrin Frigji ta lidhin, si thonë “me popullin e Maqedonisë, të quajtur *Brig*”, që sipas tyre, “kur emigroi në Azi të Vogël, u quajt *Frig*”.<sup>40</sup>

Herodoti, madje edhe Armenët i sheh si koloni frigje në atë pjesë të shkëputur të Lindjes deri në Kaukaz dhe Mesopotami. Me këtë rast ai madje përmend edhe “tokat e dardanëve në lumin Gyndes, lumë që derdhej në lumin Tigër”,<sup>41</sup> siç do të shihen edhe nga shumë të tjerë. Kjo lë për të kuptuar se Brygët ose Frigjët dhe Pajonët madje në afërsi të përhershme të Maqedonasve, nuk ishin tjetër pos fise dardane nga shumë të tillë që kishte kjo popullatë, që vinin nga bota Pellazge dhe lashtësia e saj, dhe se kjo shtrirje, ku nuk përjash-tohen madje as Hititët dhe perandoria e tyre edhe kur dëshirohet të shikohet në lëvizje për t'u konfirmuar disa teoria ariane sipas të cilës ishin Helenët ata që në shekullin XI depërtuan në Lindje, duket fare e paqëndrueshme karshi fakteve historike që fiset e supozuara dardane (Brygët ose Frigjët dhe Pajonët) nuk paraqisnin tjetër pos një bashkësi etnogjuhësore, ku Dardanët shfaqen si faktorë kryesorë të këtyre realiteteve shoqërore, kulturore dhe politike.

Pavarësisht të dhënave të shkapërderdhura rreth raporteve të ndërsjella etnike të Pajonëve dhe Brygëve si dhe “varësisë” së tyre nga faktori dardan në përbërje të mundshme të tyre (si fise), që sipas Budimirit shpjegohet me shtresimin e përbashkët paleoeuropian, që ai e quan pellazg, megjithatë kuadri historik i mbretërisë Frigje (në Azinë e Vogël) lidhet me mbretërinë e tyre midis viteve 1140-800 para e.s., me kryeqendër Edesën, pra diku në shekullin XII, kur mendohet se duhet të ketë filluar shkollimi i mbretërisë dardane pas luftërave të ndërsjella brenda llojit, të cilat Homeri do t'i bartë në “Iliadë”, disa shekuj më vonë.

Sipas Hommandit ata depërtuan nga veriu diku rreth vitit 1200 para erës sonë me ç'rast, nga pjesa veri-perëndimore e Maqedonisë u ndanë në tri drejtime:<sup>42</sup> në perëndim kah bregdeti Adriatik, ku rreth vitit 1170 arritën në Epida-

---

<sup>39</sup> Shih: Laurent, Peter Edmund: “*An Introduction to the Study of Ancient Geography: With Copious Index to the Whole*”, London 1747, faqe 480, cituar sipas Laçej, Naim. “*Tanagra*”, Lezhë 2012, faqe 197.

<sup>40</sup> Taylor, Isaac: “*Herodotus, Translated From the Greek, For the Use of General Readers; With Short Explanatory Notes*”, London 1829, Libri VII, faqe 75.

<sup>41</sup> Po aty.

<sup>42</sup> Shih: Hammond, N.G.L: “*A History of Macedonia*”, 1981, faqe 412-414.

mus;<sup>43</sup> në jug kah Moloset dhe Kaonët;<sup>44</sup> në – lindje në drejtim të Pajonisë, prej nga mendohet se kaluan në Azi të Vogël,<sup>45</sup> por që një pjesë e tyre vazhdoi të qëndronte në Pajoni.<sup>46</sup>

Përkundër të dhënave të pakta rreth mbretërisë frigje, megjithatë, mund të thuhet se mbretërit frigjë më të shquar ishin Gordias dhe biri i tij, Midas (në shekullin VIII para erës sonë). Gordias kishte kryeqytet Gordionin e famshëm, qytet në brigjet e lumit Sangarios. Autorët antikë njoftojnë se mbretëria e frigjëve ishte e fuqishme në gjithë Antolinë, që pas disa shekujsh do të shkatërronhet nga pushtuesit cimerianë. Nga ato të dhëna të turbullta mund të kuptohet se më pas, Frigjia u përfshi në mbretërinë lidiane, ndërsa emri Frigji vazhdoi të përdorej nga Grekët dhe përfundoi duke u zëvendësuar me atë të Galatias, nga emri i pushtuesve galatë (keltë) të shekullit III p.e.s. Po ashtu, thuhet se Brygët (Frigjët) e mbetur në Trakë do të shpërndaheshin ngapak kudo në Ilirik,<sup>47</sup> me çka ushqehet edhe ajo e panjohura e kamotshme rreth fuqisë së Brygëve (Frigjëve) në hapësirat euro-aziatike, veçmas në Ilirik dhe në Maqedoni, ku gjurmët e tyre vërtetojnë praninë, jashtë ndonjë reference të caktuar kohore dhe shoqërore e politike me të cilën do të rindërtohej fuqia e tyre e njëmendë.

Fokusimi i Hammandit të mbretëria frigje si dhe ardhja e tyre nga pjesa veri-perëndimore, gjen mbështetje të qëndrimi i M. Aref, me të vetmin ndryshim se ky mendon se Brygët (Frigjët) janë një popull i vjetër nga familja pellazge, i shkëputur nga dyndja e dytë e madhe e mijëvjeçarit të dytë, duke vërshuar (të shoqëruar nga vëllezërit e tyre të një gjaku, Trakët dhe Ilirët) prej brigjeve të Danubit të mesëm drejt Ilirikut dhe më pas edhe në Azinë e Vogël.<sup>48</sup> Homeri ata i sheh në Askani, në fushën e trojanëve,<sup>49</sup> prej nga e kanë burimin disa njoftime se rreth shekullit XIII, emri i (Brygëve) Frigjëve, zëvendësoi atë të Trojanëve. Fakti se mbreti i tyre “Migdoni hyjnor”, përmendet nga Homeri në luftën e Trojës, tumir pretendimet se kanë qenë pjesë e familjes pellazge si

---

<sup>43</sup> Sipas Appianit, Brygët, të cilët në kohën e Hrrakliut erdhën nga Frigjia, e pushtuan Durrësin dhe pas largimit të tyre, qyteti ra në duart e Taulantëve ilir, kurse më vonë në duart e Liburnëve ilirë. (Appiani: *Bella Civilla*, II,39).

<sup>44</sup> Sipas Scymnit “Kjo tokë ka një liqen, të cilin Brygët e quajnë Lynhid (Liqeni i Ohrit)... Sipas këtyre, këtu banojnë Brygët barbarë” (*“Perihegesis”*, 23, faqe 433,436).

<sup>45</sup> Frashëri, Kristo: *“Etnogjeneza e shqiptarëve”*, Tiranë, 2013, faqe 100.

<sup>46</sup> Shih Herodoti: “Astrigora, me qëllim që të fyente mbretin Dar, dërgoi në Frygi një njeri tek Pajonët, të cilët Megabazi u kishte sjellë nga Strymoni si rob dhe banonin atëherë në një fshat të Frygisë” (*“Historie”*, V, faqe 98).

<sup>47</sup> Aref, Mathieu: *“Mikenët=Pellazgët”*, Tiranë, faqe 196.

<sup>48</sup> Aref, Mathieu: *“Mikenët=Pellazgët”*, Tiranë, faqe 196.

<sup>49</sup> Shih: Homeri: *“Iliada”*, II, 862.

shumë e shumë popuj të tjerë që morën pjesë në atë luftë hipotetike,<sup>50</sup> që sipas të gjitha indikacioneve, është zhvilluar midis popujve pellazgë katër shekuj më parë. Madje, as versioni i rishkruar i “Iliadës” në kohën e Pizistratit (shekulli VI para erës sonë), ndonëse është munduar t’i fsheh këto realitete, megjithatë, edhe me futjen e Grekëve në skenën historike në përputhje me konceptin e helenizimit, nuk ia ka ndryshuar përmbajtjen këtij realiteti.

Në të vërtetë, fundi i Brygëve (Frigjëve) parashtron pyetjen rreth asaj se çfarë gjuhe flisnin ata, kur dihet se nga disa burime thuhet se versioni i mirëfilltë i “Iliadës”, pra ai jashtë redaktimit nga redaksia e Pizistratit (shekulli VI p.e.s.) mund të ishte në frigjisht, një e folme dardane (dialekt i Pellazgjishtes)?<sup>51</sup>

Këto dhe hamendësime të ngjashme, që edhe më tutje presin përgjigje meritore me ç’ka pastaj hapen mundësitë për t’iu afruar edhe të panjohurave të tjera, ku padyshim një vend të rëndësishëm zë edhe ajo e sqarimit të gjurmëve të tyre në Ilirik, por edhe në disa pjesë të tjera të hapësirës dardane dhe asaj trake, ku ata, përkaj Pajonëve dhe Pirusteve, kanë lëvizur dhe duken gjithnjë e më të kapshme.

Nëse gjurmët e tyre në Ilirik, në disa pjesë të hapësirës dardane dhe asaj trake, ndërliiden me lashtësinë pellazge dhe si të tilla mund të gjejnë shpjegim me shtrirjen e Dardanëve dhe të Dardanisë në një hapësirë të gjerë euro-aziatike, ku ata nga shekulli XV para erës sonë, si urë midis dy botëve, shfaqen thuajse në të gjitha zhvillimet shoqërore dhe politike, gjuha e tyre që tashmë dihet se i takon familjes indoeuropiane si dhe hitishtja, këtë supozim e bën edhe më të besueshëm. Edhe pse nga kjo gjuhë, në kohën tonë deri tani ka arritur vetëm një mbishkrim, sipas të cilit është parë se ajo kishte katër rasë lakimesh (emërore, gjinore, kallëzore dhe rrjedhore), se kishte tre gjini (mashkullore, femërore, asnjane) dhe kishte dy kategori gramatikore të numrit (njëjës dhe shumës), disa gjuhëtarë kanë nxjerrë përfundimin se frigjishtja kishte disa pika takimi me greqishten, të cilat vlerësohet se kanë rrjedhur nga fqinjësia e gjatë me Grekët kur Brygët (Frigjët) banonin në Gadishullin Ilirik, në hapësirën midis Dardanëve dhe Pajonëve, në fqinjësi të përhershme me Maqedonasit.<sup>52</sup>

---

<sup>50</sup> Po aty, III,186.

<sup>51</sup> Më gjerësisht, Laçej, Naim: “*Tanagra*”, Lezhë 2012, faqe 163-196; Krispi, Xhuzep: “*Shqipja nënë e gjuhëve*”, Palermo 1831. Filologu arbëresh thotë se Dardanët, Frigjet dhe Pellazgët kishin të njëjtën gjuhë, gjurmë të së cilës vërehen sot te gjuha shqipe dhe se gjurmët e disa zakoneve frigje, bashkë me ato të gjuhës, mund të jenë ruajtur që nga kohet e sovranëve maqedonas, sepse kombi i lashtë i ruan si gjuhën, ashtu edhe zakonet. (Shih faqe 20-21.)

<sup>52</sup> Frashëri, Kristo: “*Etnojgjeza e Shqiptarëve*”, Tiranë 2013, faqe 99.

Duke iu referuar kësaj çështje, filologu Milan Budimir, kur bën fjalë për dallimin e *velarëve* dhe *labiovelareve* të frigjishtes, si karakteristike të një shtresimi tepër të vjetër gjuhësor, e gjen të njëjtë me atë të shqipes prej nga ai nxjerr përfundimin për shumë afri të këtyre gjuhëve në sistemin fonetik. Me këtë rast ai merr për shembull fjalën frigje βοκοκ(ov).<sup>53</sup>

Siç paralajmëron edhe filologu Budimiri, mbishkrimi i zbuluar në Azinë e Vogël, nxori në pah edhe disa pika takimi të frigjishtes me shqipen, për të cilat mendohet se kanë rrjedhur nëpërmes ilirishtes kur ata jetonin në një hapësirë të përbashkët.<sup>54</sup>

Të tilla fjalë janë: *anar*, në frëngjisht “*burrë*”, në shqip “*njeri*”; *belte*, në shqip “*baltë*” ose “*pellg*”; *germe* - në frëngjisht “*nxehtësi*”, në shqip “*zjarrmi*”; *kakon*, në shqip “*keq*”; *maternë* frëngjisht “*nënë*”, në shqip “*motër*”.<sup>55</sup>

Këtu hyn edhe fjala frigjisht “*becos*”, në shqip “*bukë*”, që ka një histori më vete, të cilën e sjell Herodoti të ndërlidhur me një sprovë të mbretit Psamitik për të parë se cili ishte populli më i vjetër i botës, pasi që ai nuk e besoi traditën e përhapur atëherë se egjiptianët e quanin veten populli më i vjetër i botës.<sup>56</sup>

Si rëndom, gjuhëtarët janë ndarë në dysh rreth lidhjes së kësaj fjale të vjetër “*becos*” (βεχος) në frigjishte me “*bukë*” të shqipes. Ndër ata që e pranojnë këtë lidhje ndër të tjera janë J. R.von Xylander (Ksylander), Dh. Kamar-da, F. Ribezzo (Ribeko), K. Ostir, N. Jokl, C. Tagliavini etj.

Por, dijetarë të tjerë, si F. Miklosich (Mikloshiq), G. Mayer. W. Meyer-Lübcke (Lybke), S. Puscarius, G. Weigand etj., e shohin të vështirë lidhjen e fjalës shqipe “*bukë*” me fjalën frigjishte “*bekos*”, meqë Ilirët, nga të cilët Shqiptarët duhet të kenë marrë këtë fjalë, nuk ishin, sipas tyre, në kontakt me Brygët (frigjët) që banonin në Azi të Vogël.<sup>57</sup>

Me ata që e shohin të vështirë lidhjen e fjalës shqipe “*bukë*” me atë frigje “*bekos*” u pajtua madje edhe E. Çabej, që sipas tij fjala “*bukë*” nuk vjen nga

<sup>53</sup> Shih Budimir, Millan “*Grci i Pelasti*”, Beograd 1950, faqe 11.

<sup>54</sup> Frashëri, Krishto: “*Etnogjeneza e Shqiptarëve*”, Tiranë 2013, faqe 100.

<sup>55</sup> Po aty.

<sup>56</sup> Sipas Herodotit, mbreti Psamit, për ta vërtetuar se cila është gjuha më e vjetër e botës, mori dy foshnje të sapolindura dhe ia dha një bariu që t’i rriste së bashku me bagëtinë e tij. E porositi bariun që të dy foshnjat t’i mbyllte në një kasolle, të ndalonte çdo njeri që të fliste me ta dhe t’u dërgonte një dhi që t’i ushqente me qumështin e saj. Në këtë mënyrë mbreti donte të dinte se cilën fjalë të parë do ta shqiptonin foshnjat kur të rriteshin. “Dy vjet më vonë”, shkruan Herodoti, “kur bariu hapi derën e kasolles, dëgjoji të dy foshnjat duke u zvarritur të bërtisnin: “*Becos!*!” “*Becos!*!”. Herën e parë bariu nuk i dha rëndësi fjalës, por mbasi i dëgjoji disa herë, ai lajmëroi mbretin. Mbreti Psamitichus pasi pyeti, mori vesh se frygët quanin *bekos* – *bukën*. Në këtë mënyrë, ai përfundoi se frygët ishin populli më i lashtë i botës”. (Shih: Hero-doti: “*Historitë*”, Libri L II.I.)

<sup>57</sup> Shih:Frashëri, Krishto: “*Etnogjeneza e Shqiptarëve*”, Tiranë 2013, faqe 99.

frigjishtja, “*bekos*”, por nga latinishtja “*bucca*” (gojë, faqe fryrë), që sipas tij, në latinishten popullore *bucca*, e ka kuptimin e *kafshatës*.<sup>58</sup>

Historiani K. Frashëri nuk e pranon vlerësimin e Çabejt dhe të disa gjuhëtarëve të tjerë për të mohuar lidhjen etimologjike të dy fjalëve kaq të ngjashme midis tyre *bukë* shqip nga *bekos* frigjisht, që mbështetet vetëm mbi argumentin e distancës gjeografike midis Ilirëve Ilirikë dhe Brygëve (frigjëve) anatolikë, meqë sipas tij, ajo duhet rishikuar.<sup>59</sup>

Kristo Frashëri vlerëson se pavarësisht fatit të mëtutjeshëm të Brygëve në Ilirik si dhe shtegtimeve të saj në një hapësirë euro-aziatike, kjo popullatë e stërlashtë banonte në trevën juglindore ilire në kufi me Maqedonasit, trevë, në të cilën bënte pjesë edhe vendbanimi neolit-eneolit i Maliqit, në qarkun e Korçës. Frashëri thotë se mund të supozohet se banorët proto indoeuropianë që krijuan qytetërimin eneolitik të shtresës së dytë të kulturës së Maliqit (Maliqi II), qenë Brygët (Frigjët) indoeuropianë, prej nga ai nxjerr përfundimin se “nuk ka përse të çuditemi që gjuha shqipe ka trashëguar nëpërmjet Ilirishtes fjalën “*bukë*” nga “*bekos*”, nga vetë Frygët që banonin në trevat ilire”.<sup>60</sup>

Mospajtimi i historianit K. Frashëri me të ashtuquajturën “distancë gjeografike midis Ilirëve të Ilirikut dhe Brygëve (Frigjëve)”, në parim është i drejtë. Me arsyetimin se “gjuha shqipe ka trashëguar nëpërmjet ilirishtes fjalën “*buka*” nga “*bekos*” nga vetë Frigjët (Brygët) që banonin në trevat Ilire”, Frashëri vë në dyshim qëndrimet e njohura të historiografisë europiane të shekullit XVIII dhe XIX rreth trajtimit të Pellazgëve si popull indogjen, pra i zhdukur dhe të pellazgjishtes – gjuhë e shkrirë në shumë gjuhë. Por, meqë konceptet e indoeuropianishtes dhe të arianizmit mbështeten mbi themelet e helenizmit skematizues, atëherë, është e pritshme që edhe argumentet çfarë janë ato që shqipen e lidhin me gjuhën bryge, gjithnjë sipas stereotipeve të klisheve të indoeuropianizmit dhe arainizmit, të futen në hambarin e quajtur “parahelen” me çka çështjet kamuflohen ose njëanshëm mbyllen!

Këto pikëpamje joshkencore, që kanë prekur dhe dëmtuar më së shumti çështjen pellazge si djep i qytetërimit antik e me të edhe atë ilire, dardane, trake, maqedonase, e të tjera të kësaj vazhdimësie, e ku ajo shqiptare luan një rol të veçantë, jo rastësisht kanë anashkaluar ose marginalizuar Brygët (Frigjët)

---

<sup>58</sup> Shih: E.Çabej: “*Studime etimologjike në fushë të shqipes*”. Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë Vëll. II. 1976, faqe 357.

<sup>59</sup> Shih Frashëri, Kristo: “*Etnogjeneza e Shqiptarëve*”, Tiranë 2013, faqe 100.

<sup>60</sup> Po aty, faqe 102.

dhe popujt e tjerë nga familja e madhe pellazge e shtrirë në Mesdhe, në Azi të Vogël e deri në Mesopotami. Realitetet shoqërore dhe politike nëpër të cilat do të kalojnë këta popuj, qoftë edhe si të shkëputura, siç na vijnë nga dioptria e autorëve antikë dhe mbështetësve të tyre, të lidhura, pa mëdyshje se ndërtojnë pamjen e një kuadri gjithëpërfshirës historik mbi të cilin, së paku nga mesi i mileniumit të dytë e deri te fundi i tij, ata që diku-diku quhen “proto-Ilirë arkaikë”, pra popujt pellazgjikë në Azinë e Vogël (Dardanët, Trojanët, Moskët, Frigjianët ose Brygët, Etruskët e të tjerët) për të cilët tashmë besohet se nëpërmes rrjedhës së Danubit pushtuan veriun prej nga vazhduan përhapjen e tyre të njohur nëpër gjithë Europën Qendrore deri te gadishujt Apenin dhe Iberik. Me organizimet e tyre të para shoqërore dhe politike, ku e kanë zanafillën ato që i njohim si mbretëri *dardano-trako-maqedono-ilire*, shfaqen të shtrira në lindje dhe perëndim njëherësh. Ndër to gjithsesi e rëndësishme, krahas asaj të Trojës, është edhe ajo frigje, apo bryge, me të cilën mund të shpjegohet edhe esenca e periudhës parahelene me qytetërimet egjeo-kretase si pjesë e atij pellazg, që pastaj, nga shekulli XIX para erës sonë e deri në atë VI para erës sonë, do t’ia hapë rrugën periudhës arkaike (*strictosensu*), në të cilën shfaqet Greqia dhe kështu nga shekulli IV p.e.r. e këndeje, njohim periudhën helene, por në versionin e filohelenizmit evropian të shekullit nëntëmbëdhjetë, që u duhej zhvillimeve politike të kohës.

Edhe pse autorët antikë, për aq sa mund t’u besohet, kanë lënë mjaft dëshmi se bota tutje tyre, pra ajo e cilësuar si “barbare”, ka qenë e thellë, ka qenë e gjerë dhe po ashtu ka qenë e organizuar mirë nga lart-poshtë, dhe se prej saj janë marrë thujtë të gjitha vlerat mbi të cilat është mbështetur qytetërimi i tyre. Megjithatë, fabrikuesve të “helenizmit modern”, ato jo vetëm që nuk u kanë mjaftuar për ta rindërtuar pamjen e antikitetit për aq sa kjo mundësohet nga një largësi e tillë, por ata kanë bërë çmos që ajo të shkëputet e shokëlohet sa më shumë që të jetë e mundur nga tërësia e vet. Kjo shkëputje që ka bërë që historiografia e sotme, në vend se të merret me trungun dhe rrënjët, merret me degët dhe gjethet madje, kundrim ky, që si po shihet, siç është rasti i interpretimit të fjalës frigje (bryge) “*bekos*” shqip “*bukë*”, çështjet i përmbys ashtu që ato nuk shikohen nga koka por nga bishti. Me kokë nënkuptohet që pikënisje e shpjegimit të kësaj fjale dhe të tjerave nga një lashtësi e madhe të jetë monogjeneza e gjuhëve dhe etnia e përbashkët nën një perandori pellazge ose mbretëri dardane, ku duhet parë të përfshira edhe mbretëritë e tjera nga ajo frigje, lidiase, maqedonase e ato ilire, dhe jo e kundërta. Ndërsa me bisht nënkuptohet

marrja me diçka të shkëputur dhe si pjesë e të tjerave, pra jashtë së përbashkëtës dhe rrënjës, me ç'rast deduksioni çështjen e kthen në problem, në vend se ta zgjidhë në përputhje me esencën e saj.

Të kësaj natyre, gjithsesi janë edhe dilemat rreth Hititëve, si një popull i lashtë, i cili në arenën historike shfaqet nga fillimet e mileniumit të dytë në pjesën e mesme të Azisë së Vogël. Për të është menduar se nuk u takon popujve indoevropianë.<sup>61</sup>

Nga një mori pllakash të zbuluara në Boghaz Keiu apo Boghazky, del se Hititët, si sumerë, kanë folur një gjuhë indoevropiane, ndër më të vjetrat, që T. Bryce, pasi që nga shumë gjuhëtarë të ketë marrë njoftimin se asgjë e saj nuk shpjegohet me greqishten e vjetër, hitishtja do t'i asociojë, me atë të Ilirëve,<sup>62</sup> pikërisht në përputhje me një lidhje etnike dhe më vonë shoqërore dhe politike midis Dardanëve, Trojanëve, pastaj (Brygëve) e Frigjëve deri te Hititët, të cilën, sikur e dedikojnë më së miri fosilet e gjuhës së përbashkët.

Edhe përkundër kësaj të dhëne, disa filogrekë janë munduar me çdo kusht që emrin e mbretit *Akagamuns apo Akhaiava=Akhava*, duke e barazuar rrënjën "AKH" me atë indoevropiane "AQU"(ujë, lumë), ta lidhin me fjalën *Akenë(Akhaioi)* në greqisht. Kjo, megjithatë, nuk ka qenë e mundur ngaqë kalimi prej AQU në AKH nuk mund të bëhet në greqisht.<sup>63</sup>

Mosshpjegimi i fjalës *Akenë (Akhaioi)* me greqisht dhe pranimi i variantit hitit si "i pazbërthyesëm", megjithatë hap çështjen e *Akenëve* si popull i lashtë, emri i të cilëve lidhet edhe me Maqedoninë antike, për të cilët, nga Homeri

---

<sup>61</sup> Mendohet se nga fillimi i mileniumit të dytë para erës së re, Hititët dhe Luvitët, pushtojnë Azinë e Vogël qendrore të populluar me shumicë nga proto-Hititët, popuj aziatikë. Aty themeluan perandorinë e lashtë hitite. Hatusi e zhvendos kryeqytetin e tij në Hatusa prej nga merr pjesë në fushata ushtarake kundër Sirisë dhe Babilonisë. Në shekullin XVI p.e.s. bie në sy mbretëria hitite e drejtuar nga Mitani, i lidhur me popullin e lashtë hurrit. Mes viteve 1380-1190 p.e.s. kemi Perandorinë e Re Hitite. Nën mbretërimin e Sapoliuluma Hititët bëhen një fuqi e madhe dhe pushtojnë një pjesë të madhe të Azisë së Vogël. Në vitin 1294, në betejën e njohur të Kadeshit, ku do të marrin pjesë edhe Dardanët, Hititët pësojnë humbje nga egjiptasit me çka nis edhe shkatërrimi i perandorisë së tyre. (Shih Aref, Mathieu: "*Mikenët=Pellazgët*", Tiranë, faqe 313.)

<sup>62</sup> Trevor Bryce, ka botuar një studim të plotë në lidhje me hititët, ku pos të tjerash thotë se "duke ju referuar emrave të mbretërve hititë, shikohet se ata kanë prapashtesën *-ili*, mënyrë e cila i identifikonte ata me yllin, me diellin, Zotin më të fuqishëm në antikitet. Përveç Ilirëve dhe Hititëve, nuk ka asnjë popull tjetër në Azi apo Europë, që të përdorë prapashtesën *-ili* pas emrit të një mbreti. Mes gjuhëve semitike, prapashtesa *-ili*, tregon thjesht Zotin." Hititët dhe Ilirët kishin të njëjtën kulturë e qytetërim dhe të njëjtën gjuhë". Në studimin e mësipërm bëhet një analizë e bazuar mbi elemente gjuhësore dhe gjetje arkeologjike. Pra, qytetërimi i cili ka lënë të gdhendur mbi gurë figurën e simbolit më të fuqishëm e më të pushtetshëm të antikitetit, ka pasardhës ata që flasin akoma gjuhën e tij, ka pasardhës Shqiptarët. Shqiptarët, pasardhësit e Ilirëve, janë "pronarët e ligjshëm" të një simboli të cilin e mbante një popull që themeloi qytetërimet më të mëdha të antikitetit. Më gjerësisht shih: "*The Kingdom of the Hittites* (Mbretëria e hititëve), Oxford 1998.

<sup>63</sup> Shih: Aref, Mathieu: "*Mikenët=Pellazgët*", Tiranë 2008, faqe 360.



kemi njoftime se ishin prijësit e atyre që nisën luftën kundër Trojanëve, ku krahas me Dananët, pasardhës të Danaos egjiptianit dhe Argionëve, banorë të Argosit, kishte edhe Akenë apo të qytetit të Argos. Autorët antikë, Akenët i paraqesin popullatë “të ardhur” dhe të vendosur në pjesët e tokave pellazge, midis “barbarësh”, që do të thotë se ata ishin Pellazgë, por duket se pllakat hitite, sikur ruajnë një shpjegim tjetër për Akenët si pjesëtarë të konfederatës së fuqishme hitite prej 24 shtetesh, nga të cilat një shtet quhej *Taroisa*, *Troisa* (*Troai=Troja?*).<sup>64</sup> Thuhet se këtë “popull të madh detar”, të vendosur në kufijtë e Lisisë dhe të Pamfiliës së ardhshme, pas ndarjes me perandorinë hitite, ata i mundi një tjetër mbret i *Akhijavas*, bashkëkohor i mbretit hitit, Antaravas.<sup>65</sup>

Natyrisht se të dhënat gjuhësore nga këto mbishkrime, për aq sa ato janë zbërthyer, i kanë shtyrë disa gjuhëtarë që të bëjnë përqasje midis “*Agakamunas*” hitit dhe “*Agamemnon*”, mbret i Mikenës, si dhe midis “*Antavaras*” dhe “*Andreus*”, mbret i parë i Orkomenos në Beoti,<sup>66</sup> vend ky që dihet se lidhet me njohjen e parë historike të Pellazgëve dhe pasardhësve të tyre Dardanëve, Ilirëve, Maqedonasve dhe të tjerëve.

Megjithatë, përjashtimi i lidhjeve të hititishtes me greqishten e vjetër si dhe kërkimi i mundësive që ato të gjenden te familja e ilire-dardane e me këtë edhe te gjuha shqipe (po qe se kjo trajtohet nga rrënja dhe jo nga degët siç ngjet rëndom), ka të bëjë me qëndrimin e njohur të atyre gjuhëtarëve sipas të cilëve në Ilirik dhe në Azi të Vogël duhet llogaritur te indoevropianët jogrekë (Dardanët, Pajonët, Brigët, Maqedonasit dhe të tjerët nga trugu i etnisë iliro-trake) si një shtresim shumë më i vjetër nga ai që njihet pas pushtimeve greke në këto hapësira.<sup>67</sup>

## MAQEDONASIT DHE DARDANËT

Raportet midis Maqedonasve dhe Dardanëve janë të natyrës etnike, ku të përbashkët e kanë rrënjën pellazge si dhe modelin e mbretërive, karakteristikë për organizimin shoqëror dhe politik në kuadër të konfigurimit të gjithëmbarshtëm iliro-trakas. Këto, raporte, megjithatë, si në planin etnik dhe në

---

<sup>64</sup> Po aty.

<sup>65</sup> Po aty.

<sup>66</sup> Po aty.

<sup>67</sup> Më gjerësisht shih: Budimir, Milan “*Grci i Pelasti*”, Beograd 1952, faqe 51-55; Jokl, Norbert: “*Untersuchungen zur indogermanischen Schprah-und Kulturwissenschaft – Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen*”, Berlin und Leipzig 1923; Georigew: “*Hetitische und etruskisch: die hetitische Herkunft der etruskischen Sprache*”, Sofia 1962.

atë shoqëror-politik, kanë veçoritë e veta, sidomos në rrethanat kur njëra ose tjetra etni kanë përfshirë edhe faktorë të tjerë (fise), apo kur njëra ose tjetra mbretëri kanë luftuar për shtrirjen e pushtetit të tyre brenda “familjes” dhe jashtë saj.

Në këtë aspekt, nga pikëpamja mitologjike dhe ajo historike, faktori dardan në raport me atë maqedonas është ndikues dhe përcaktues madje, siç është në përgjithësi edhe në raport me mbretëritë e tjera ilire, ngaqë Dardanët dhe Dardania, nga shekulli XIV p.e.s. shfaqen në mënyrë thuajse aktive në të gjitha zhvillimet euro-aziatike (themelues të Trojës, njëherësh të ndërlidhur me mbretërinë frigje dhe paraprakisht edhe në lidhje me atë hitite) për t’u “rrudhur” në mbretërinë dardane në qendër të Ilirikut, në shekullin V p.e.s., ku fillon rivaliteti me luftërat e njohura me mbretërinë maqedonase deri në mesin e shekullit II p.e.s., kur mbretëria maqedonase do të mundet nga Roma, ndërsa etnia maqedonase, thuajse në tërësi, nga pikëpamja administrative dhe kulturore (gjatë Bizantit dhe gjatë Perandorisë Osmane) do të përthithet nga ajo dardane.

Për t’u parë sa më mirë këto raporte dhe për t’u zbërthyer në përputhje me zhvillimet e njohura nga ngritja e Maqedonisë në një mbretëri botërore në kohën e Aleksandërit të Madh në shekullin IV p.e.s., është i domosdoshëm fokusimi paraprak te Dardanët dhe Dardania si dhe roli i tyre kyç në kalimin e mirëfilltë të Pellazgëve tek formacionet e caktuara etnike dhe shoqërore, prelud ky që nis nga mitologjia greke, kalon nëpërmes kujtesës historike deri te ajo poetike (Hesiodi, Homeri, Eskili, Sofokliu, Virgjili e të tjerë).

Sipas mitologjisë greke, *Dardani* ishte bir i *Zeusit* dhe i *Elektrës* bijës së *Atlasit* dhe i vëllai i *Jozonit* dhe i *Harmonisë*.<sup>68</sup> I detyruar që me djalin e vet, *Idalin* ta linte vendlindjen, *Arkadinë*, ai shkoi në *Frigji*, që kishte një popullsi tyrene-pellazge, në shtëpi e pret *Kadmi*, i cili u martua, ose e rrëmbeu *Harmoninë*. Prej këtu shkon te *Teukrët* dhe u martua me vajzën e tij, *Batejan* dhe në brigjet e *Skandrës* themeloi *Trojën*. Ai konsiderohet stërgjysh i fiseve dardane që jetonin në faqen e malit *Ida*.<sup>69</sup>

Mitologjia greke po ashtu të një origjinë hyjnore e merr edhe mbretin e parë të *Trojës* (*Ilos*) *Ilin*, i cili shihet si bir i *Troit* dhe i nimfës *Kaliro*, baba i *Laomedonit* dhe gjysh i *Priamit*. Në *Frigji* (*Azi* të *Vogël*) ai themeloi qytetin e *Atena Paladës*, që për nder të tij u quajt *Ilion* (më vonë *Troja*).<sup>70</sup>

---

<sup>68</sup> Homeri: Po aty, faqe 361

<sup>69</sup> “Fjalor i mitologjisë”, Prishtinë, 1988, faqe 62.

<sup>70</sup> Po aty, faqe 121.

Ky është versioni më i përgjithshëm mitologjik i pedigresë së Dardanit, themeluesit të fisit e më vonë të popullit dardan. Por, mitologjia përmend edhe gjenealogji të tjera të Dardanit. Ai shihet në pjesë të ndryshme të asaj që do të njihet si botë pellazge me një shtrirje të gjerë. Kështu, në njërin prej këtyre gjenealogjive thuhet se mbreti i parë i Korinthit ishte Corinthus apo Korinthus, i cili kishte pasur dy gra, njëra prej tyre, Elektra, i kishte dhënë dy djem: Dardanusin dhe Iasiusin.<sup>71</sup> Ndërsa nga një tjetër rrëfim bëhet e ditur se i ati i Dardanit, nuk është Zeusi e as Korinthusi, por Cortytos ose Corythus, që ishte mbret i Samothrakës. Me këtë emër Corytus, që ishte edhe emri i lashtë i Kortonës toskane (Cortona), lidhet vendlindja e Dardanusit në versionin italian të gjenealogjisë së tij. Pra, sipas kësaj, Dardanus i ka babë Coritusin, mbretin e Toskanës.<sup>72</sup>

Nga Toskana Dardanus i ikën dhe shkon në ishullin e Samothrakës dhe prej këtu në Frigji, e më pas themelon Trojën. Gjithnjë sipas kësaj legjende, Diodorusi, Dardanit që ka një vëlla Jasionin, i shton edhe një motër që quhet Harmoni dhe në fakt ky është në mitologji opinionin më i përgjithshëm për gjenealogjinë e Dardanit, që në njëfarë mënyre hap dy çështje të tjera tepër të rëndësishme: e para ka të bëjë me ndikimin semitik në civilizimin evropian, ngaqë ka të bëjë me atë se Kadmos fenikasi është dhëndër i Dardanit; dhe çështja e dyta, ka të bëjë me raportet etnike dardane-ilire nga një këndvështrim tjetër nga ai që jemi mësuar, ngaqë sipas këtij versioni mitologjik Kadmosi dhe Harmonia (motra e Dardanit) ikin nga Teba e Beotisë dhe vijnë në Iliri te fisi i Enkelejve. Gjatë kohës që kanë qenë në Iliri ata kanë një djalë me emrin Ilir, prej të cilit morën emrin Ilirët, gjë që sipas kësaj gjenealogjie mitologjike, Ilirët paraqiten nipa të Dardanëve, sado që mbetet pa u sqaruar se ishin Ilirët ata që i dhanë emrin djalit të Kadmosit, apo ky i fundit ua dha emrin atyre.<sup>73</sup>

Për A. Charles kjo dilemë nuk ekziston, meqë, sipas një versioni mitologjik që sjellë ai, Dardani ishte martuar dy herë, dhe se, gruaja e parë ishte arkadianja Chryse, me të cilën kishte dy djem: Ideus dhe Dimas. Ndërsa gruaja e dytë quhej Bafia ose Basia apo Batieia dhe me të Dardani kishte përsëri dy djem: *Ilus* dhe *Erichthonius*.<sup>74</sup>

---

<sup>71</sup> Shih Le Fevre, R: “*The Destruction of Troy, in Three Books*”, London, faqe 13.

<sup>72</sup> Më gjerësisht shih “*The Works of Virgil Translated Into English Prose*”, London 1826, faqe 314, ku thuhet: “Dardanus dhe Iasius kishin së bashku nënë Elektrën, vajzë e Atlasit dhe gruaja e Coritus, mbret i Toskanës”.

<sup>73</sup> Shih Laçej, Naim: “*Tanagra*”, Lezhë, 2012, faqe 165-166.

<sup>74</sup> Po aty, faqe 166.

Pra, edhe gjenealogjia morale e tyre, nga shënimet e Biblës, ata i radhit ndër popujt e parë që nga zanafilla. Duke shpjeguar pasardhësit e Noas, Gjenezës<sup>75</sup> tregon se ata ishin Shemi, Hami dhe Jafeti. Djemt e Jafetit ishin Gomeri, Magogi, Madai, Jovani, Tubali, Meshechi dhe Tiras.<sup>76</sup> Djemtë e Jovanit ishin Elishah, Tarshish, Kittim dhe Dardanim.<sup>77</sup>

S. Clark thotë se nipi i Jafetit dhe djali i Jovanit, Dardonimi ishte Dardani.<sup>78</sup> Ky vlerësim do të mbështetet edhe nga historianë dhe teologë të tjerë, të cilët, edhe sipas interpretimit të librave të shenjtë bëjnë barazimin e *Dodonimëve Dardanë*. Profesorët e teologjisë Keil dhe Delitzsch *Dadonimët dardanë* i shohin të vendosur në tërë territorin e Ilirisë, ose në veri të fiseve greke.<sup>79</sup>

Me këtë del në pah se një pjesë e madhe e fiseve pellazge të Ilirisë ishin Dardanë,<sup>80</sup> prej nga pastaj Arkadia por edhe Epiri mund të shihen si një epiqendër e mirëfilltë e Dardanëve si një familje e madhe me shumë e shumë fise, që i kanë takuar kësaj dinastie ndër më të vjetrat, ku madje duhet kërkuar daljen dhe ngritjen e tyre shoqërore dhe politike në skenën historike si fise dhe mbretëri të fuqishme që njihen dhe nuk njihen por që nga autorët antikë ato janë parë të shkapërderdhura dhe të emërtuara si etni gjeografike.

Pa marrë parasysh se nëpër legjenda greke dhe të tjera, Dardanit i shihen gjurmët herë në Arkadi si Pellazg, herë në Kretë, e herë në Etruri, megjithatë, edhe si i tillë, ai gjendet në krye të zanafillës së qytetërimeve më të njohura të botës antike në përgjithësi. Për të edhe sot bisedohet rreth origjinës së njëmendtë pikërisht pse nuk është grek, pra me atë që e lidh me Pellazgët, gjegjësisht Dardanët, të cilët në antikitetin e hershëm kishin një rol vendimtar, në mos, kryesorin në atë kapërcim historik ndër më të mjegulluarit për nga të dhënat, por ndër më të rëndësishmit për nga zhvillimet që vuri në veprim.

---

<sup>75</sup> Shih "The Holy Bible, Containing the Old and New Testaments", London, 1850, GENESIS IX:18.

<sup>76</sup> Po aty, GENESIS,X:2.

<sup>77</sup> Po aty, GENESIS,X:4.

<sup>78</sup> Shih Clark, Samuel: "The Bible Atlas of Maps and Plans to Illustrate the Geography and Topography of the Old and New Testament and the Aprocryha, with Explanatory Notes", London 1868, faqe 3 "Gesenius kishte parë (Thes.p.1266) që fjala Dardonim mund të ndryshohet natyrshëm duke u bërë Dardan, dhe ky opinion është mbështetur nga Targmus", (Cituar sipas Laçej, Naim "Tanagra", 2012, faqe 166).

<sup>79</sup> Shih Keil, Carl Friedrich dhe Delitzsch, Franc: "Biblical Commentary On The Old Testament", Edinburgh, 1866, faqe 164.

<sup>80</sup> Më gjerësisht shih Jones, Alonzo Trevier: "Epires Og the Bible", New York, 2004 faqe 16: "Dodani ishte stërgjysh i Dardanëve, një pjesë e të cilëve jetojnë në vendin e quajtur prej tyre Dardani, në fqinjësi me Trojën e lashtë, në bregun jugor të Detit Marmara. Të tjerët, pjesa kryesore e tyre populloi Ilirinë ose Ilirikumin, vendin që kufizohet me detin Adriatik përballë Italisë. Prej këtu disa prej fiseve të tyre shkuan në Itali, prej të cilëve Liburnët dhe Venetët janë veçanërisht të përmendur".

Sidoqoftë, Dardanët si bijë të Pellazgëve, me një shtrirje tepër të gjerë (nga Azia e Vogël, Greqia, Iliriku Qendror e deri në Itali), me çka me të drejtë, u atribuohet roli kryesor në botën antike në formimin e një baraspeshe shoqërore, politike po edhe kulturore,<sup>81</sup> nuk i gjejmë vetëm te mitologjia greke dhe ajo romake, por edhe te poetët dhe dramaturgët e hershëm grekë të antikitetit për t'u parë të tillë edhe nga poetët romakë, gjë që ishte e natyrshme që muzat të merreshin me aktorët kryesorë, ata që silleshin midis pushtetit hyjnor dhe atij tokësor. Të tillë, Dardanët do të shihen edhe nga Romakët dhe të tjerët.

Nëse, sipas mitologjisë greke, shfaqja e Dardanit dhe Dardanëve ishte “vullnet” i perëndive, që duhej të luftonin përhershëm për ngritje, pra për fron mbretëror dhe perandorak, i cili duhej të shtrihej sa më larg dhe sa më thellë drejt një piramide botërore, sipas Homerit, në këtë mision hyjnor, Dardanët shihen themelues të Trojës, drejtues të saj gjatë kohës së lavdisë me “mandatin” e perëndive dhe të ndërthurur me bëmat e tyre në luftë për pushtet. Këtë na e paraqet poeti i madh kur thotë:

*“Pastaj Dardani bëri Eriktronin”*

*Eriktoni, mbret i trojanëve*

*Trojin e polli, e Trojit i lenë tre djema”*.<sup>82</sup>

Para se të paraqiten në Trojë dhe të shihen të rëndësishëm në zhvillimet që i paraprinë ngritjes dhe rënies së saj, ku gjithsesi rol të madh ka luajtur fuqia e tyre shoqërore dhe politike, megjithatë ata me dukjen në Frigji (Brygi) dhe te Hititët (me të parët pjesëmarrës në luftëra të përbashkëta, dhe me të dytët pjesë e konfederatës), shfaqen edhe më thellë në hapësirën historike.

Në këtë kapërcim dramatik, natyrisht se Dardanët edhe më vonë mbesin akterë kryesorë të shumë zhvillimeve, meqë pas humbjes së luftës së hipotetike të Trojës, pjesë të tyre (Galabrët, Thunatet, Daonët e të tjerë) vazhduan drejt jugut të Italisë, ku do të vendosen dhe, si shihet, do të kenë ndikim në themelimin e Romës.

Kështu, te Homeri heronjtë e “Iliadës” kryesisht ishin Pellazgë dhe Dardanë. Këtë na e dëshmon më së miri edhe gjenealogjisti i njohur i historisë së lashtësisë Clinton, i cili duke u mbështetur pikërisht te “*Iliada*” e Homerit, familjen mbretërore trojane dardane e nxjerr me orgjinë pellazge.<sup>83</sup>

---

<sup>81</sup> Shih: Papazoglu, Fanula: “*Srednjobalkanska plemena u predrimsko doba: Tribali, Autoriati, Dardanci, skordici i Mezi*”, Sarajevo, 1969 dhe Mirdita, Zef: “*Antroponimia dardane në kohën romane*”, Prishtinë, 1981.

<sup>82</sup> Homer: *Iliada*, Tiranë, 1979, kënga e 20, faqe 361.

<sup>83</sup> Më gjerësisht shih: Clinton, Henry Fynes: “*Fasti Hellenici. The Civil and Literary Chronologi of Greece, From the Earliest Acconts to the LV*”, Oxford, 1834, vol I, f. 88. Sipas Clinton-it, gjenealogjia e familjes

Rreshtimet e tyre në luftën e Trojës “në anë të ndryshme”, sigurisht kanë të bëjnë me versionin e Pizistratit të shekullit V, që duhej t’i shkonte përshtati shfaqjes së Greqisë historike, me të cilën duhej të anashkalohej roli i tyre si themel i helenizmit.

Sidoqoftë, te Homeri, Priami, mbret i Trojës, cilësohej pasardhës i Dardanit.<sup>84</sup> Sipas tij Dardani kishte qenë mbreti i parë i Trojës dhe i kishte dhënë emrin qytetit të Dardanisë. Prandaj, Priami dhe populli i tij quheshin Dardanë, bijë dhe bija të Dardanit.<sup>85</sup>

Dardanët nga Homeri përmenden në këto vargje:

“*Dardanin* e lindi së pari Zeusi rembledhës.”<sup>86</sup>

“*Dardani* lindi pastaj një bir, mbretin *Erikthon*”.<sup>87</sup>

“*Dardani*, të cilin biri i Kronit e donte mbi të gjithë djemtë”.<sup>88</sup>

“Dëgjomëni, Trojanë, *Dardanë* dhe ndihmës”.<sup>89</sup>

“Trojanë dhe Lykas dhe *Dardanë* që luftojnë nga afër”.<sup>90</sup>

“*Dardanëve* u printe djali trim i *Ankisit*”.<sup>91</sup>

Të dhënat e poetit të madh rreth Dardanëve dhe Trojës, në themelet e të cilës i sheh ata, siç sheh edhe mbretërinë që do ta drejtojë atë, nuk janë vetëm pjellë e fantazisë, ose pjesë e mitologjisë greke. Përkundrazi, ato kanë edhe mbështetje historike, që si u pa në shqyrtimet paraprake, sa vijnë dhe plotësojnë tablonë e faktorit kyç, që lidh trekëndëshin e antikitetit midis botës pellazge, asaj helene dhe romake.

Edhe Hesiodi, bashkëkohës ose diç më i vjetër se Homeri, Dardanët do t’i përshkruajë bijë të Pellazgut, që kishin qeverisur së pari Arkadinë, si një vend që ndodhej midis qendrave pellazge të Argosit dhe Spartës, prej nga, sipas tij,

---

mbretërore dardane në Trojë fillon me Dardanusin, vazhdon me Erchthoniusin, Tros, që kishte tre djem: Ilos, Asaracus dhe Ganymedes, ku i pari (Ilos) kishte djalë Leomedon, i dyti (Asaracus) kishte të birin Capus, prej të cilit kemi Anchiesin dhe së fundit Eneu. Leomedoni, i biri i Ilosit kishte pesë djemë: Tithonusin, Priamin, La,pusin, Clytiusin dhe Hicetonin. Priami kishte djalë Hektorin. Nga pedigreja homeriane e dardanëve tërheqin vëmendjen edhe dy të dhëna të tjera, ku e para lidhet me emrin e njërit prej vëllezërve të Priamit, Klitit (Clytius), emër të cilin e mbante edhe njëri prej gjeneralëve të shquar të Aleksandir të Madhe; ndërsa e dhëna e dytë lidhet me emrin e pasardhësit të Trosit, Ganymedes, emër të cilin e përdorin Shqiptarët edhe sot në formën Gannimete(s). (Rreth vlerësimit të fundit shih: Laçej, Naim: “*Tanagra*”, Lezhë 2012, faqe 171)

<sup>84</sup> “*Iliada*”, III, 38; VII, 89.

<sup>85</sup> Po aty, XVIII,230.

<sup>86</sup> Po aty, kënga XX, vargu 215.

<sup>87</sup> Po aty, kënga XX vargu 219.

<sup>88</sup> Po aty, vargu 304.

<sup>89</sup> Po aty, vargu 456.

<sup>90</sup> Po aty, Kënga VIII, vargu 173.

<sup>91</sup> Po aty, Kënga II, vargu 819.

kishin zanafillën ngjarjet tepër dramatike, të cilat do t'i paraprijnë kohës historike dhe gjithë asaj që paraqet antikitetet.<sup>92</sup>

Gjithnjë sipas këtij shkrimtari të rëndësishëm të antikitetit, duke qenë lëvizës i ngjarjeve tepër të rëndësishme, thuhet se ky popull i lashtësisë u shpërngul në drejtim të Azinë së Vogël dhe e lidhi fatin e vet ngushtësisht me Trojën, një nga portat e së cilës mori emrin “Porta Dardane”. Ndërsa ngushtica në Gadishullin Ilirik u quajt Dardanele dhe, duke shkuar më në Perëndim, në pjesën qendrore të Gadishullit (Kosova e sotme, bashkë me Maqedoninë dhe Serbinë Jugore) themeluan shtetin e fuqishëm - Dardaninë, njërin ndër më të qëndrueshmit dhe ndër më të rëndësishmit.<sup>93</sup>

Me ngjarjet dramatike me shumë tragjedi, ku vëmendja e krijuesve përherë do të sfidohet nga Troja dhe ato që do të ndodhin në të dhe përreth saj, do të merret edhe Euripidi (482-406) para erës sonë. Nga njëra anë, në dramën e tij portretizohet Menelau, mbret i Argosit, stërgjyshërit e tij përmes Herkullit ose Herakliut të *Heraklidët*, e shoqja Helena, i vëllai Agamemnoni, njëra bijë të dy dramat: “*Ifigjenia në Aulidë*” dhe “*Ifegjina në Tauridë*”, bija tjetër të “*Elektra*”, kurse i biri tek “*Orestia*”. Nga ana tjetër, Euripidi pasqyroi pasojat tragjike të familjes së Priamit, mbretit të Trojës, në dramën rreth së shoqes *Hekubes*, nuses së të birit të *Andromakës*, vejtës së Hektorit, aleatit të tij, *Resusit* dhe popullit të vet “*Gratë trojane*”.<sup>94</sup>

Edhe poeti i madh Virgjilinë “*Eneidë*” gjithashtu merret me Dardanët dhe fatet e tyre për t'i kthyer kështu në personazhe të njëjës prej tragjedive më të rëndësishme të antikitetit.

“Atëherë ai Eneu, të cilin Ankisiti *Dardan*, jetëdhënësja Venus pranë dallgës së Simoentit frigas ia lindi”.

(Libri I, 617-618)

“O dritë e *Dardanëve* zemër e forcë,  
Vetë ai i nxit perënditë kundër armëve *dardane*”.

(Libri II, 617-618)

“O *Dardanë* të shumëvuajtur, toka ku së pari  
Lindën stërgjyshërit tuaj, po ajo tokë e pasur  
Do t'iu presë tani që po ktheheni. Kërkojeni nënën e lashtë.  
Këtu shtëpia e Eneut do të sundojë mbi gjithë brigjet,

<sup>92</sup> Hesiodi: “Fragmente”, 160.

<sup>93</sup> Jacques, Edwin: “*Shqiptarët*”, Tiranë, 2007, faqe 59.

<sup>94</sup> Jacques, Edwin: “*Shqiptarët*”, Tiranë, 2007, faqe 61.

Dhe bijtë e bijve e ata që do t' lindin prej tyre.”

(Libri III, 94-98)

“Ne kemi ardhur pas teje dhe armëve tua, si u dogj *Dardania*”.

(Libri III, 156)

“Këto janë selitë tona të veçanta, këndeje ka lindur *Dardania*”.

(Libri III, 167)

Fuqia etnike dhe historike e Dardanëve dhe e Dardanisë në përmasat reale, ato nga shekujt XVI para erës sonë, nga ajo e supozuar e një mbretërie të fuqishme euro-aziatike e deri te ajo realja në shekujt V para erës sonë deri te shekulli I pas erës sonë, pra deri te pushtimet romake, në të vërtetë tregon edhe fuqinë e Maqedonasve dhe të Maqedonisë nga dinastia e tyre që shfaqet në shekullin VII para erës sonë e deri te ajo e perandorisë botërore gjatë kohës së Aleksandërit të Madh, në shekullin IV para erës sonë, ngaqë ajo është ngritur por edhe dobësuar në raport me këtë faktor gjithnjë i shikuar edhe me përbërësit e saj (Pajonët, Brygët dhe të tjerët) diku në mes.

Megjithatë, për raporte reale, atyre etnike dhe shtetërore, pra për një pamje historike midis Maqedonasve dhe Dardanëve si dhe Maqedonisë dhe Dardanisë, mund të flitet për kohën nga shekulli VII p.e.s. deri te shekulli I i erës sonë, po qe se kjo mbështetet mbi kufij jugorë te Dardanëve dhe të Dardanisë me Maqedonasit dhe Maqedoninë, prej nga del edhe fuqia e njërit apo tjetrit.

Edhe pse materialet epigrafike, ato gjuhësore dhe arkeologjike shpeshherë nuk janë në gjendje të përcaktojnë përkufizimin etnik e më pak atë shtetëror midis Maqedonasve dhe Dardanëve ngaqë ato shkrihen përherë në tërësinë e lëvizjeve më të mëdha të popujve dhe të kulturave të tyre si dhe të ndikimit të atyre më të vonshme nga koha e pushtimeve romake (romanizimit dhe të helenizimit gjatë Bizantit), megjithatë, kufijtë etnopolitikë shfaqen më të kapshëm, ngaqë sado kudo ruajnë shtrirjen e natyrshme të etnive, qoftë edhe si të diferencuara nga amza e përbashkët, që në këtë rast është ajo pellazgo-ilire. Në këtë aspekt, vijëzimi i përkufizimit midis Dardanëve dhe Maqedonëve nga pozicioni i atyre jugor i parë nga ana e Dardanëve me Maqedonasit dhe verior nga ana e Maqedonasve në raport me Dardanët, nxjerr në pah faktorët kulturor, shoqëror dhe ata politik të së njëjtës rrënjë (pellazge), siç nxjerr në pah thuajse edhe ai perëndimori (me Epirotët dhe Ilirët) të njëjtën. Ndërsa kufiri jugor i Maqedonasve me Grekët dhe i Maqedonisë me Greqinë pasqyron dallimin thelbësor ose ndryshimin etnik me Grekët, paçka se grekët do të mundohen që helenizmin si filo-



zofi shoqërore që do ta përvetësojnë Maqedonasit për ta bërë pjesë të politikës së tyre imperialiste të perandorisë botërore gjatë mbretërisë së Aleksandërit të Madh.

Pra, kufijtë etnopolitikë midis Maqedonasve dhe Maqedonisë me Dardanët dhe Dardaninë, për të parët si kufij veriorë, ndërsa për të dytët kufij jugorë, gjithnjë të “turbulluar” me faktorin Pajon diku në mes të tyre (në veri)<sup>95</sup> dhe Brygët ose Frigjet në drejtim të Trakës dhe Azisë së Vogël, kanë si pikë të pashmangshme, por tejet të rëndësishme, pikëpjekjen në trekëndshin midis Dardanisë, Dalmacisë dhe të Maqedonisë nga Scardus Mons (malet e Sharrit), gjegjësisht Korabin,<sup>96</sup> duke përfshirë këtu edhe pjesën e Tetovës (Oeneum) dhe të Gostivarit, përtej Suva Planinës në drejtim të lumi Treska, që i takojnë Dardanisë. Prej andej kufiri lëshohet majave të Jakupicës te katundi Vodno, diku në jug të Bylozarit (Vesit të sotëm), ku lumi Pčinja derdhët në Vardar. Ky kufi vazhdon kah malet Ovçe Pole drejt majave të maleve të Osogovës në jug-perëndim për te qyteza Zletovo, ku gjendet pika e përbashkët e tri provincave: Moesia Superior si trekufi midis Dardanisë, Maqedonisë dhe Trakisë, aty ku edhe fillon kufiri midis Dardanëve dhe Dardanisë.<sup>97</sup>

Sipas autorëve antikë, *Bylazori* (Vesit)<sup>98</sup> shënon pikën e fundit jugore të kufizimit të Dardanëve me Maqedonasit, anipse sipas Polibit dhe Tit Livit, ky ishte qytet pajon.<sup>99</sup>

Si do të shihet, kufijtë etnopolitikë midis Dardanisë dhe Maqedonisë do të ndryshojnë herë pas here midis shekujve V dhe II p.e.s. në përputhje me fuqinë e njëjës apo tjetrës mbretëri si dhe luftërat e tyre të ndërsjella, të cilat do të vazhdojnë edhe pasi që këtyre mbretërive do t’u kërcënohet rreziku nga Roma dhe luftërat e saj pushtuese në hapësirat e tyre nga shekulli i dytë para erës sonë, kur edhe Maqedonia do të pushtohet prej tyre, për të vazhduar edhe më vonë, deri në shekullin e parë pas erës sonë, kur edhe Dardanët do të humbin mbretërinë e tyre.

---

<sup>95</sup> Ndonëse Pajonët janë shtrirë në veri të Maqedonisë, në brezin që i ndanë nga Dardanët, përgjatë qyteteve Bylazor, Pripel dhe Shtip, edhe më parë ata kanë populluar një pjesë të madhe të Maqedonisë, gjë që jo rastësisht se para depërtimit të Maqedonasve, Peonia është quajtur *Emathia*.

<sup>96</sup> Korabi shihet si kufi juglindor i Dardanëve dhe i Dardanisë, ku ata kufizohen me Penestët, fis ilir, që shtrihet nëpër shtatin e Drinit të Zi, nga liqeni i Ohrit dhe shkon në veri deri te juglindja në Sharr.

<sup>97</sup> Mirdita, Zef: “O južnoj granici Dardanaca i Dardanije”, VMZA, 3.s.XXXII-XXXIII, 69-92, faqe 63.

<sup>98</sup> Sipas Tomashekut, emri i Bylozarit është fjalë ilire “*Buxxy = grad*”, që shpjegohet me shqipen “ura”, që sipas Hahnit do të thotë: *qytet-urë*. Shih te “*Studime shqiptare*”, Tiranë, 2009, faqe 166. Këtë pikë-pamje ka edhe G. Kazorow, kur thotë se turqit e quajnë “*Köprülü*” = *qytet i urave*.

<sup>99</sup> Shih: Polyb: V,97, I dhe Liv Tit:XLIV, 26,8: “*Mittit Antigonum (...) qui gubernet multitudinem Gallorum ad Byzalozore – Paeoniae ist locus est-castra movere*”. Në kuadër të Pajonisë, këtë qytet e sheh edhe Wallabank, 1940: 63: “*Bylazora, a ton in Paeonia commanding the pass over into Dardania*”.

## MAQEDONASIT, EPIROTËT DHE HELENËT

Fillimi i Heladës, sipas Skylaksit, që njëherësh duhet të nënkuptojë edhe përfundimin e asaj që nga Helenët quhet Iliri, hap çështjen e qëndrimit të Helenëve ndaj Pellazgëve dhe trashëgimisë së tyre (Ilirëve, Epirotëve, Maqedonasve, Dardanëve, Pajonëve dhe të tjerëve në këtë rrethim), jo vetëm në planin gjeografik, por edhe në atë shoqëror dhe politik, qëndrim ky që ndërlikon ata thuajse në të gjitha zhvillimet e rëndësishme të tyre, pa marrë parasysh si dhe sa (s) pranohet kjo.

Kjo pamje historike e Pellazgëve, po ashtu ka edhe dy pamje të brendshme: atë të hershmen, kur helenët e mirëfilltë, nga shekulli XIX e këndeje të parë si Grekë, do të vijnë në atë që do ta quajnë Heladë pas dyndjes dorike (diku nga mesi i shekullit X para erës sonë) dhe aty do të gjejnë “Pellazgët hyjnorë”. Dhe, ka pamjen e helenizmit, nga ai i hershmi e deri te klasiku, kur, sipas burimeve antike, kolonët e ardhur nga përtej detit (sipas shumë burimeve nga Egjipti), pasi që të kenë përvetësuar prej Pellazgëve gjithë ato që ata kishin (besimin, idhujt, hyjnitë, pa përjashtuar këtu edhe mundësinë e shkrimit që ata e kishin nga Fenikasit, të cilët ishin degë e Pellazgëve), do t’i kthehen zhvillimit të tyre të njohur shoqëror, politik dhe kulturor ndër më të rëndësishmit e antikitetit.<sup>100</sup>

Ndërkohë që mbetjet e Pellazgëve, me përjashtim të Dardanëve dhe të Maqedonasve, do t’i quajnë Ilirë (popuj ilirë), ndërsa hapësirën e tyre Iliri (Illirien), sado që ata do të përmenden vetëm atëherë kur kanë ndonjë raport të jashtëm me Helenët të konvertuar më vonë në Grekë e assesi në kuadër të ndonjë pasqyrimi të tyre të brendshëm me anën e të cilit mund të nxirret ndonjë e vërtetë për ta.<sup>101</sup>

Por, edhe kjo do të mjaftojë që të dalë në shesh e vërteta për një popull parahelen, që ishte takuar prej tyre atje, që do t’i shërbejnë rindërtimit të kuadrit historik për ta dhe të kaluarën e tyre.

Me gjithë këtë qasje, që mund të quhet dokumentuese nga një burim i drejtpërdrejtë, që mbetet i pashmangshëm dhe ndër më të rëndësishmit, nga një këndvështrim tjetër, më i thellë, vlerësuese mbetet pamja mitologjike për Pellazgët dhe origjinën e tyre, ku shihen si “popull hyjnor”. Me këtë epitet pranohet

---

<sup>100</sup> Më gjerësisht shih: Diodori: *Veptra III*, kaptina 66, faqe 257; Jochen Georg von Hahn: “*Studime Shqiptare*”, Tiranë, 2009, faqe 396.

<sup>101</sup> Shih Straboni: “*Gjeografia*”, Libri V/1

epërsia e tyre shpirtërore dhe ajo kulturore me të cilën kolonët do të ndeshen sapo të shkelnin vendet pellazge, ku ata do të marrin shumë nga vlerat e tyre, që do t'u shërbejnë për të shkuar më tutje. Në këtë kundrim kemi Trojën dhe Dardanët, por edhe qytetërimin e Kretës dhe atë të Mikenës, si përqendrim themeltar të antikitetit, që ndonëse do t'i mohohet autorësia pellazge, megjithatë, me pranimin e të ashtuquajturit “shtresim parahelen”, si protoeuropean ose “paleuropian” vihet në lidhje me paragrekët, që pranohet se ishin Pellazgët, që nënkupton edhe Trojën qendër dardane. Themelimi i Trojës, sipas legjendës greke lidhet me Dardanin, të birin e Zeusit dhe të perëndeshës Elektra, prej nga përfytyrimi mitologjik, i cili në këtë rast është shumë afër të vërtetës historike, do t'i bëjë të pavdekshëm.

Edhe pa këtë version të mitit, Dardanët dhe fiset e tjera dardane nga shekulli XVI par erës sonë e këndej shihen si veprues aktivë në zhvillimet që do t'i paraprijnë Trojës dhe fuqisë së saj, (në perandorinë hitite, atë bryge dhe të tjera në hapësirën euro-aziatike), me ç'rast fati i tyre shihet i lidhur edhe me të nga ngritja e deri te rënia e saj përfundimtare.

Por, nëse Dardani, themeluesi i Trojës, në kujtesën helene mbetet i përhershëm dhe i nderuar jo vetëm nga vepra e Homerit (pse ishte hyjnor dhe të tillët janë të pavdekshëm po aq sa edhe të paprekshëm), kjo nuk do të vlejë gjithaq për pasardhësit e Ilirit (Iliosit), mbretit të parë të tokave ilire, që prej tyre do të quhen Ilirë dhe hapësira e tyre Iliri, meqë ai vinte nga *mbreti-njeri*, Kadmi i lashtësisë, që megjithëqë ua solli dijen dhe shkrimin nga Fenikia, prej nga thuhet se pastaj vazhdon qytetërimi antik, që në botë do të shfaqet si helenizëm, trashëgimia e tij (Ilirët dhe Iliria) nuk mund të pranoheshin për helenë, e as të ruanin nderimin e përhershëm, siç kishin Dardanët e Trojës “Pellazgë hyjnorë”.

Këtu dhe te kjo çështje, pra te *babai-mbret* (Kadmi nga Fenikia), misionar që sjellë dije, kulturë dhe shkronja dhe, *i biri-mbret* (Ilios i Iliri-së), barbar dhe i huaj “në fqinjësi”, gjërat sikur zënë të kthehen nga e natyrshmja, të mundësia që historia nga mjegulla e mitologjisë t'i lirojë faktet për t'ua dhënë atyre vendin dhe pamjen e njëmendët, që do të thotë se në ato kohë *babë-bir-mbretër* dhe *mbretër-mbretëri* mund të kishte nga lidhje të njëjta gjaku dhe në të njëjtin vend, që po ashtu do të thotë se Kadmi (*baba-mbret*) dhe Iliri (*i biri-mbret*) mund të kenë qenë në Feniki ose në Iliri dhe assesi njëri në një vend e tjetri në një tjetër, aq më tepër kur ato vende midis kishin një det të madh dhe botë të ndryshme.

Historia këtu, për ndryshim prej mitologjisë, mbështetet në dëshmi, dhe meqë edhe ato që vijnë nga autorët antikë flasin për Ilirët dhe Ilirinë në një kohë dhe vend të caktuar edhe para se të vinin Helenët, atëherë është shumë më afër

mendsh që Kadmi, qoftë edhe si fenikas, i parë ashtu që mbretëria tokësore të mos u njihet të bijve të Pellazgut, Ilirëve, supozon për lidhjen e përbashkët të tyre brenda hapësirës së të njëjtës etni me të njëjtin qytetërim, e shtrirë tutje detit, siç është shtrirë edhe në Kretë dhe, bazuar në dëshmitë e shumta arkeologjike, duhej të ketë shkuar edhe në Afrikën e Veriut.

Te ndarja e natyrshme midis mitologjisë dhe historisë që vjen nga antikiteti, nga burime helene kemi edhe fillimet e pasqyrimet historik të Pellazgëve dhe shfaqjen e tyre historike, të shumtën, nga dioptria e tyre, pavarësisht pamjes së saj prej andej, kjo nuk pengon që asaj t'i shihet tërësia, qoftë edhe si një mozaiku me shumë pjesë që atë e plotësojnë.

Andaj, po qe se lihet anash mitologjia dhe përfytyrimet e saj të njohura me shumë e shumë pamje dhe forma, atëherë del paksa më i qartë qëndrimi Helenëve ndaj pasardhësve të Pellazgëve, të cilët në fqinjësi të afërme apo të largët, të shumtën do t'i shohin si Ilirë (ndonëse të shkapërderdhur në fise dhe mbretëri fisesh), një emërtim oponim, i ngjashëm me atë nga Heleni për Helenët, ose Itali për Italikët. Nga ky përgjithësim shpeshherë bëjnë përjashtim Epirotët (Molosët), Dardanët dhe Maqedonasit dhe madje jo pa arsye. Sepse, këta të fundit, pasi që do të pushtohen prej tyre dhe do të pranojnë epërsinë e gjuhës greke si gjuhë zyrtare, do të shihen helenë, edhe pse ata nga shumë autorë antikë do të cilësohen si barbarë. Por, kjo, ata i kthen pashmangshëm te rrënja pellazge prej nga nuk mund të përjashtohen edhe po qe se sjellja e tyre politike gjatë helenizmit klasik (shekujt VI-I) i afron më shumë me Helenët se sa me farefisninë e tyre, sidomos me Dardanët, që supozohet se mund të ishin një fis i tyre, edhe pse do të jenë në luftëra të vazhdueshme dhe të ashpra madje, që mund të shpjegohen si luftëra brenda familjes për mbizotërim, të natyrshme në ato kohë dhe gjithnjë, siç ishin edhe luftërat e përgjakshme për fron midis vëllezërve zanafilla e të cilave ka të bëjë me egon dhe vullnetin për pushtet te çdo qenie. Historikisht dihet se shumë etni të njëjta por edhe popuj do të përçahen mbi këto baza prej nga pastaj kemi edhe shtetet e ndryshme nga të njëjtat etni apo popuj, siç ka ndodhur me familjen kelte, me atë balte, sllave, të degëzuara në shumë shtete dhe të ngjashme, ku jo rrallë gjeo-grafia do t'ua përcaktojë pamjen shoqërore dhe politike si dhe emërtimin.

Edhe pa këtë kundrim, që duhet pasur parasysh kur shqyrtohen raportet e brendshme të familjeve të mëdha të popujve nga antikiteti e tutje dhe realitetet që kanë dalë prej tyre (popujt e ndryshëm dhe më vonë kombet dhe shtetet e shumta), dëshmi të drejtpërdrejta që vijnë nga antikiteti bëjnë të ditur qartë se Maqedonasit an-

tikë, rrënja pellazge e të cilëve assesi nuk mund të mohohet, pak ose fare pak përputhen me skemat shoqërore, kulturore të helenizmit. Ata më shumë mbesin në kuadër të përkufizimit rreth perandorisë hyjnore, me rendin mbretëror, që nga koha e organizimeve të para fisnore e tutje, të cilin, Dardanët dhe fiset e tjera ilire do ta mbajnë si formë e qeverisjeve gjatë gjithë kohës, derisa do të rrënohet nga pushtuesit romak kur ata pas shtatë monarkive do t'i kthehen republikanizmit.

I kësaj natyre, pra, ishte edhe projekti i Aleksandërit të Madh për perandorinë botërore si pikëpamje hyjnore nga bindja se kishte prejardhje hyjnore, që vinte nga lidhja e së ëmës, Olympisë, një epirote, së cilës i kishte hyrë në shtrat Zeusi në trajtën e gjarprit.<sup>102</sup>

Bindjen se luftonin për një perandori botërore, për të cilën u dallua Aleksandri i Madh, do ta ketë edhe Pirro Molosi, i cili jo vetëm sipas mitologjisë greke, kishte lidhje të drejtpërdrejtë me Dardanët, meqë Epiri, në njëfarë mënyre, shfaqet si pjesë e zhdëmtimit të humbjes së Trojës, të cilën Eneu, si Dardan, pasi që të ketë kaluar nëpër ato vende, do t'i drejtohet jugut të Italisë për ta themeluar Trojën në Perëndim, siç do të ndodhë në të vërtetë me Romën.

Pa marrë parasysh ngatërrimin me mitin trojan, Dardanët, Maqedonasit dhe Epirotët kanë trajtim të veçantë nga përkufizimi i njohur *ilir*, ku përfshihen fiset e shumta në fqinjësi të Helenëve edhe ato të tjerat që shtriheshin tutje në pjesët e tjera të Ilirikut Qendror dhe atij Verior e Lindor pa përjashtuar këtu edhe ato që do të shfaqen në Italinë e Jugut, edhe pse Dardanët dhe ndonjëherë Epirotët do të shihen të lidhur me fiset e tjera ilire, ndërsa Maqedonasit “barbarë” të helenizuar. Madje, nga koha e shfaqjes së Aleksandërit të Madh në vitin 338 para erës sonë e deri te pushtimi romak i tyre, Maqedonasit merren bartësit kryesorë të helenizmit. Kjo ka ndikuar që në shekujt e mëvonshëm, filohelenistët të heqin që të gjitha dyshimet e mundshme që Maqedonasit i ndajnë nga Helenët, siç do të përjashtojnë çfarëdo të menduari se ata mund të jenë në farefisni me Dardanët dhe Epirotët (me këta të parët edhe si fis i tyre) nga shkak i prejardhjes së përbashkët nga Pellazgët. Madje, këtë do ta përjashtojnë edhe atëherë kur do të kenë para shumë nga dëshmitë e autorëve të njohur antikë, të cilët Maqedonasit, ndonëse do t'i shohin në kuadër të konceptit shoqëror grek dhe atij të helenizmit në përgjithësi (natyrisht pasi që ata të jenë ngritur ushtarakisht mbi ta), edhe më tutje do t'i trajtojnë si barbarë, pra të huaj.

---

<sup>102</sup>“*Fjalori i mitologjisë*”, Prishtinë, 1988, faqe 256-251; Mirdita, Zef: “*Mitet dhe mitologjia në antikë*”, Prishtinë, 1988, faqe 38, 43,226.

Sidoqoftë asimilimi gjuhësor i aristokracisë Maqedonase si dhe përfshirja e detyrueshme e Helenëve në fushatën e Aleksandërit të Madh për ta krijuar perandorinë botërore drejt lindjes, ku ai duke mundur një nga një perandoritë e fuqishme, do të arrijë edhe deri në Indi, nuk do t'i bëjë ata Helenë, siç mendohej e as nuk do t'i privojë nga origjina e tyre pellazge, siç dëshirohej. Përkundrazi, vlerësohet se helenizmi si një zhvillim i hovshëm i kohës do t'ua hapë rrugën për depërtime të reja kah Lindja, por koncepti shtetëror për të cilin do të luftohet, ishte i zanafillës pellazge. Kjo do të bëjë që Maqedonasit të shihen Pellazgë, ndërsa bindja për perandorinë tokësore me origjinë hyjnore, pra e një natyre superiore e *mbretit-njeri* me origjinë nga zotat, në të vërtetë, do të mbetet te mentaliteti dardanilir i luftës për hapësira sa më të mëdha dhe për liri, vetëdije kjo politike që do të pasqyrohet edhe te Pirro molosi pak kohë pasi që të dështojë projekti i Aleksandërit të Madh kah Lindja, me të vetmin ndryshim që për këtë qëllim ai kishte zgjedhur Perëndimin dhe rrugën që para disa shekujsh e kishte bërë Eneu, si më të afërmen, më të mundshmen, e mbi të gjitha, më të natyrshmen.

Megjithatë, faktet e tjera, në radhë të parë ato historike dhe gjuhësore, që vijnë nga autorët antikë, ose nga studiuesit e më vonshëm të gjuhësisë krahasimtare, flasin se Epirotasit ishin nga rrënja pellazge, siç ishin edhe Maqedonasit dhe dinastia e tyre mbretërore<sup>103</sup>, pavarësisht atyre që do të ndodhin para dhe pas kohës së Aleksandërit të Madh dhe, po ashtu, pa marrë parasysh luftërat e shumta që Maqedonasit kishin pikërisht me Ilirët, dhe veçmas me Dardanët, kur edhe pjesërisht do t'ia dalin t'i nënshtrojnë, siç ndodhi në kohën e Filipit II, por assesi t'i bëjnë për vete që ta pranojnë helenizmin si emblemë të tyre, që shfaqej si kopje e asaj që Helenët kishin marrë dhe përvetësuar prej tyre, duke e rrudhur brenda një hapësire të ngushtuar dhe për interesa të ngushta.

Pavarësisht kundrimeve hipotetike që mëtojnë të rikthejnë diçka nga pamja e një tabloje historike bukur shumë të mjegulluar, edhe këtu, si në rastet e tjera, fjalën kryesore do ta kenë autorët e vjetër antikë. Dëshmitë e tyre, edhe pse në shumë raste të shkëputura dhe kundërtënëse, janë më meritoret, sepse me anën e tyre ndërlidhen shumë nga faktet si dhe zhvillimet historike prej nga Hahn, ndër të parët, nxjerrë këto qëndrime bazike:<sup>104</sup>

---

<sup>103</sup>Shih: Hahn: "*Studime shqiptare*", Tiranë, 2009, faqe 291.

<sup>104</sup> Po aty.

- Epirotët dhe Maqedonasit edhe në kohën e Strabonit kanë qenë jogrekë ose barbarë,<sup>105</sup>

- Epirotët, Maqedonasit dhe Ilirët janë farefis;

- Epirotët dhe Maqedonasit përbënin thelbin e Tyrreno-Pellazgëve, prej nga mund të thuhet se fiset më në skaj të këtij populli kanë luajtur rol në historinë e Italisë dhe të Trakisë;

- Ilirët në kuptimin më të gjerë janë baras me Pellazgët, siç janë edhe Dardanët, të cilët në këtë trung shfaqen si një degë e veçantë.<sup>106</sup>

Rreth çështjes së parë, e cila edhe sot mbetet e hapur dhe me shumë mospajtime, prej nga pastaj kanë burimin edhe qëndrimet e ndryshme, nga Straboni njoftohemi se “popujt e jugut janë Ilirët dhe Trakasit, që shtrihen deri në kufi të Greqisë; me këta janë përzier edhe Keltët.”<sup>107</sup>

Ky përshkrim në një farë mënyre i përgjigjet tablosë së atëhershme të hapësirës së përbashkët në pjesën qendrore dhe atë lindore midis Ilirëve dhe Trakasve, me të vetmin ndryshim se Trakasit, mund të ishin në fqinjësi me Ilirët në pjesën veri-lindor, por jo edhe me Helenët, meqë këtë e pamundësonte shtrirja e Dardanëve në Lindje që në tërësi mbulonte brezin midis tyre, gjë që si shihet kjo deman-tohet edhe nga përshkrimi i mëposhtëm që Straboni i bën pjesë lindore, ku thotë se “nga Europa na mbetet për të përshkruar vetëm ai gadishull, i cili shtrihet prej skajit të Adriatikut deri te gryka e Isterit (Danubit). Këtu banojnë Grekët, popujt e Maqedonisë dhe të Epirit dhe ato fise që shtrihen sipër tyre deri në Isteri dhe prej Adriatikut deri te Deti i Zi. Mbi Adriatikon banojnë fiset e Ilirëve dhe më tej, deri te delta e Marmarasë dhe Dardanelet, fiset e trakasve dhe, në mes të këtyre, disa fise Skite dhe kelte.”<sup>108</sup>

---

<sup>105</sup>Straboni, gjeograf dhe historian i madh grek. Lindi në Amasia të Pontit aty nga viti 63 para erës sonë dhe vdiq rreth vitit 20 të erës sonë. Një pjesë të jetës së tij Straboni e kaloi në Romë, kurse pjesën tjetër e kaloi duke bërë udhëtime nëpër vende të ndryshme të perandorisë romake, nëpër Greqi, Azi, Itali dhe Egjipt. Në bazë të vrojtimeve të tij personale nga ky udhëtim, dhe në mënyrë të veçantë duke u mbështetur në veprat e autorëve të ndryshëm antikë, Straboni shkroi veprën e tij “*Geographica*” (Gjeografia) në 17 libra. “*Gjeografia*” e Strabonit ka një rëndësi të dorës së parë dhe është një burim i vyer edhe për gjeografinë dhe historinë e Ilirisë. Çështja e përzierjes së keltëve, të cilën gjeografi i njohur e përmend, me siguri se ka të bëjë me mbetjet e keltëve, të cilët pasi që të kenë depërtuar nga veriu dhe të kenë zbritur deri në Egje, duke rrënuar më së shumti vendet dardane dhe Dardanië, kur do të pësojnë disfatë nga forcat greke dhe maqedonase, serish do të tërhiqen luginës së Vardarit dhe asaj të Moravës deri te Danubi, por që një pjesë e tyre do të mbesin në lindje, në pjesën që gjendet midis Trakasve dhe Dardanëve.

<sup>106</sup> Shih Johan Georg von Hahn: “*Studime shqiptare*”, Tiranë, 2009, faqe 291.

<sup>107</sup> Straboni: “*Gjeografia*”, libri VII, kapitulli I.

<sup>108</sup> Po aty, kapitulli V.

Përkundër këtyre lajthitjeve, të cilat janë edhe të natyrshme nëse kihen parasysh informacionet e ndryshme si dhe sistemimi i tyre, del që Straboni të gjithë gadishullin në jug të Danubit e ndan në tri pjesë:

- a) Heladën në jug,
- b) Ilirinë në perëndim dhe
- c) Trakinë në lindje.

Por, Helada që e mendon ai nuk banohet e gjitha prej Grekëve, sepse ndër krahinat veriore të saj jetojnë fiset jogreke, pra barbare, në perëndim Epirotët dhe në lindje Maqedonasit.<sup>109</sup>

Ky përkufizim që bën gjeografi i njohur është i një rëndësie të madhe meqë, si shihet, Epirotët i ndan fare nga Grekët dhe thotë “po të hyjmë në gjirin e Amb-rakisë djathtas kemi Akarnanët, të cilët janë grekë, majtas *Kasopeajt* që janë Epirotë... Përshkrimi ynë në veri dhe në perëndim të gadishullit merr fund me fiset epirote dhe ilire, në lindje me popujt e Maqedonisë, që shtrihen deri në Bizant, ku pas Epirotëve dhe Ilirëve vijnë fiset greke të Akarnanëve, Etoleëve, Kokëve etj”.<sup>110</sup>

Për Strabonin, Epirotas janë edhe *Amfilokët* dhe *Molosët*, *Atamanët*, *Etiket*, *Tymfejajt*, *Orestët*, *Parorejt* dhe *Atintanët*, të cilët jetojnë deri te malet e egra në malësinë e Ilirisë, të cilët, pos që i ndan nga Grekët, natyrshëm i lidh me Maqedoninë dhe Maqedonasit me të cilët ata do të ndërtojnë pushtet të përbashkët. E tillë ishte popullsia e krahinave të Lynkestisë, Pelagonisë, Orestisë dhe e Eleminisë që quheshin edhe Maqedonia e Epërme, që më vonë u quajt edhe Maqedonia e lirë. Në këto pjesë popujt flisnin dy gjuhë: amtaren, pra ilirishten dhe greqishten.<sup>111</sup>

Sipas këtyre të dhënave popujt e poshtëshënuar që jetojnë në Epir dhe në Maqedoni janë farefis, ose Epirotas: *Kaonët*, *Tesprotët*, *Kasopeajt*, *Amfilokët*, *Molosët*, *Atamanët*, *Etiket*, *Tymfejajt*, *Orestët*, *Parorejt*, *Atintanët* (me paranteza për *Bulionët*, *Taulantët*, *Parthinët* e *Brygët dardanë*), pastaj *Perisiadiejt*, *Enkelejt* dhe *Sesarët*.

Krahas këtyre vijnë gjashtë fise kryesore të Maqedonisë në lindje të Pindit: *Lynkestët*, *Deuriopët*, *Palaganët*, *Eordejt*, *Elimejt* dhe *Eratyrët*, që janë farefis.<sup>112</sup>

Perceptimi i hapësirës së Maqedonisë sipas Strabonit si dhe rrethimi i tyre prej Epirotëve, dhe fiseve ilire, mund të kuptohet më së miri me përshkrimin që ia bën

---

<sup>109</sup> John Georg von Hahn: “*Studime shqiptare*”, Tiranë, 2009, faqe 292.

<sup>110</sup> Po aty, 292.

<sup>111</sup> Po aty, 294.

<sup>112</sup> Po aty, faqe 294.



rrugës së njohur ushtarake “Egnatia” që shkonte prej Durrachiumit dhe Apollonisë në Thesalonik kur ai thotë se “ai që ndjek këtë rrugë prej Apollonisë, ose prej Epidamni, ka djathtas popujt e Epirit, të cilët shtrihen deri te gjiu i Ambrakisë, brigjet e këtyre lagen prej detit të Siçilisë. Majtas ka malet e Ilirisë dhe fiset që banojnë atje deri në Maqedoni dhe Pajoni. Aty ku fillon Maqedonia dhe Pajonia deri te lumi Strymon, banojnë Maqedonas, Pajonas dhe disa malësorë trakas.”<sup>113</sup>

Edhe Tukididi, sa u përket Epirotëve, ka po atë mendim si Straboni. Kjo tregohet me rastin e përshkrimit të ekspeditës fatkeqe të Lakedemonëve, Ambra-kiotëve dhe Kaonëve kundër ushtrisë së Akarnanëve:

“Me komandantin e Lakedemonëve, Knemosin, ishin prej Grekëve Ambra-kiotët, Leukadët, Anaktorët dhe njëmijë peloponezas që i kishte sjellë me vete këtu; prej barbarëve një mijë kanonas, me të cilët në luftë shkuan edhe Tesprotët. Molosët dhe Atitanët i udhëhiqte Sabylinti, kujdestar i mbretit Torys.”<sup>114</sup>

Në këtë pjesë Tukididi i quan barbarë popujt kryesorë të Epirit të vërtetë dhe të njëmijë Maqedonasit që dërgon mbreti Predika nuk i numëron te Grekët.<sup>115</sup>

Siç shihet nga të dhënat që na vijnë nga Straboni, Tukididi dhe autorët e tjerë antikë, të hershëm dhe të mëvonshëm, del se Epirotët dhe Maqedonasit, dy nga popujt më të fuqishëm që shtrihen në pjesën veriore të Grekëve dhe atë perëndimore, pra i gjithë Epiri dhe pjesët që shkojnë në lindje deri te Vardari me Pellagoninë dhe deri te Pindi, del se nuk janë Grekë e as të rrënjës greke, por njëherësh ata nuk shfaqen gjithaq të lidhur me fiset ilire të atjeshme, siç është rasti edhe me Dardanët, të cilët, të përqendruar në pjesën Qendrore të Ilirikut (nga malet e Sharit, Drini, Morava në veri e deri në Azi të Vogël), po ashtu dalin të veçuar nga Ilirët, që megjithatë, të përbashkët kanë të mosqenit helenë (së paku jo të tillë siç i krijoi historiografia e shekullit XIX).

Në të vërtetë, siç del edhe nga autorët e rëndësishëm antikë dhe siç mund të shihet edhe nga zhvillimet e mëtutjeshme historike, këta popuj (Ilirët, Dardanët, Epirotët dhe Maqedonasit janë farefis), të cilët Straboni megjithatë, i quan “popuj ilirë”,<sup>116</sup> të përbërë nga fise të shumta herë-herë edhe të përziera sa që duken të ngatërruara herë në njërën e herë në tjetrën anë,<sup>117</sup> pikërisht të përbashkëta kanë

---

<sup>113</sup> Po aty.

<sup>114</sup> Tukididi: “*Historitë*”, libri IV/126.

<sup>115</sup> Po aty, faqe 30.

<sup>116</sup> Straboni: “*Gjeografia*”, Libri V/1.

<sup>117</sup> Straboni për Antinatët thotë se janë Epirotë, kurse Skylaksi dhe Appioni shkruajnë se janë Ilirë (shih: Skylaks f. 10; *Appion bell Llyrer* 7). Ndërsa po sipas Strabonit dhe Appianit, Dardanët janë Ilirë, por Dion

lidhjen etnike (gjuhën dhe zakonet), fakt ky që shpie te gjykimi se Epirotët dhe Maqedonasit janë një farefis dhe formojnë një degë të veçantë të popullit të madh Ilir. Kjo vlen edhe për Dardanët, në fqinjësi me ta dhe të shtrirë në pjesën qendrore të gadishullit e cila shkon në lindje në Azi të Vogël, ndërsa në perëndim, në Itali dhe tutje saj, që mbi të gjitha të përbashkët kanë rrënjën pellazge.

Rrënjën e përbashkët pellazge të këtyre fiseve të rëndësishme që lidhin por edhe ndajnë botën pellazge me atë helene e pranon edhe Straboni, i cili në këtë një sheh rolin e veçantë të Epirotëve dhe Epirit si një hapësirë domethënëse.

”Shumë vetë i quajnë edhe Pellazgë fiset e epirotëve, sepse këta e shtrijnë deri këtu sundimin e tyre”.<sup>118</sup>

Kështu, gjeografi i njohur, duke i ditur realitetet etnike, por edhe të kaluarën, pasi që thekson se Pellazgët, si fis i vjetër ishin të përhapur në gjithë Heladën dhe pasi bën të ditur se kjo shtrirje përfshinte dhe Kretën, qendrën e qytetërimit të vjetër, njofton se Thesalia, e cila gjendet midis grykës së Peneit dhe Thermopileve dhe shtrihet deri në malet e Pindit, quhet *Argo Pellazgjik*,<sup>119</sup> duke thënë se Pellazgët dikur këtu qenë zot dhe vetë poeti (Homer) Zeusin e Dodonës e quan pellazgjik “*Zeusi i lartë pellazgjik i Dodonës*”, prej nga shumë autorë të vjetër edhe fiset epirote i kanë quajtur pellazgjike, sepse ata shtriheshin deri atje (Epir).<sup>120</sup>

Më tutje, për të dëshmuar gjeografinë jo vetëm si fakt, Straboni u kthehet edhe burimeve historike nga antikiteti, duke cituar Homerin, Hesiodin, Eskilin, por edhe Erforin dhe të tjerë, që Pellazgëve ua njihnin lashtësinë, por edhe trashëgiminë që shprehej me anën e një shtrirje të gjerë fisesh dhe qytetesh madje, ku edhe Athina përmendet si qendër e tyre. Madje, themelues i saj shihej mbreti i Pellazgëve, Mole, për të cilin thotë se ishte nga Regis-Vila (Itali e Jugut), ku ai kishte qendrën e vet, por që bashkë me fisin e vetë kishte kaluar detin për t’u vendosur përgjithmonë në Heladë.<sup>121</sup>

Fara e pellazgëve dhe pasardhësve të tyre në lidhje gjeografike me Italinë e Jugut dhe në një lëvizje të vazhdueshme nga njëra anë në tjetrën, sa nganjëherë ajo duket e “ngatërruar”, ka të bëjë me të vërtetën se Pellazgët, nuk është pse lëviznin andej apo kënde, siç thotë edhe Straboni, por pse ata nga mileniumi i katërt e kënde ishin të shtrirë në hapësirën e gjithë Mesdheut dhe të Egjeut edhe

---

Kasi shkruan se ata i përkisnin Mezëve, (shih: *Dio Cassius* VII, fa 495). Kjo do të thuhet edhe për Pajonët dhe Brygët (Frigjët), që herë quhen Ilirë, herë Trakas.

<sup>118</sup> Straboni: “*Gjeografia*”, Libri V, kaptina 2, faqe 221.

<sup>119</sup> Straboni: “*Gjeografia*”, Libri V/7-8.

<sup>120</sup> Po aty, libri V/7.

<sup>121</sup> Po aty, Libri V/8.

para se të vinin Grekët për t'u ngulitur në Greqi (mendohet për falangën ushtarake nga Egjipti). Këtë fakt ata nuk e dinin, por që më vonë, kur do ta mësojnë atë, atëherë është e natyrshme që rreth kësaj lëvizjeje të krijojnë tregimet e tyre të ndryshme, shumë shpërputhëse. Madje, në përputhje me këtë, ka shumë gjasa që edhe kapërcimi i njohur i një pjese të Dardanëve në Itali, pasi që ta kenë humbur luftën e Trojës, i interpretuar nga Homeri, Virgjili dhe krijuesit e tjerë, si kërkim të Eneut për ta zhdëmtuar humbjen e Trojës diku në Perëndim, të ketë qenë vetëm një kalim i natyrshëm i asaj pjese të Dardanëve, tre katër shekuj para luftës hipotetike të Trojës, në pjesën perëndimore, pra në Italinë e Jugut, ku ishin të shtrirë stërgjyshërit e tyre, Pellazgët, siç ishin të shtrirë edhe në pjesët e tjera të Mesdheut dhe tutje në Azi të Vogël e deri në veri të Afrikës. “Enigma” e Etruskëve si dhe çështja e Venetëve që do të “zbrasin” nga veriu, nuk janë tjetër pos pjesë e konfigurimit të njohur parahistorik paleoeuropian pellazgjik, mbi të cilin pastaj do të mbështetet teoria e mëvonshme e lirismit paneuropian e të ngjashme për të arritur deri aty sa ata të quhen “indoeuropianët klasikë”.<sup>122</sup>

Pavarësisht këtij vlerësimi, me të cilin do të preokupohen shumë studiues të cilët tashmë e kanë më se të qartë se “bredhja” e pasardhësve të Pellazgëve nga njëri breg i detit në tjetrin (nga ai i Jonit në atë të Adriatikut perëndimor), siç e shihnin autorët e vjetër antikë, nuk ishte tjetër pos lëvizje e natyrshme e tyre nga njëra pjesë në tjetrën, ku ata shtriheshin, gjë që edhe do të interpretohen në mënyra të ndryshme. Edhe Stefan Byzantini *Epirin Pellazgjik*, prej nga ndodhte “kapërcimi” i tyre për në Itali dhe anasjelltas, ndër të cilët më i famshmi ishte ai i Pirro Molosit për ta shtrirë mbretërinë e tij në atë pjesë që e ndjente të veten, e ndanë në dy pjesë: në *Pellazgun e Lartë* dhe në atë të *Poshtmin*.<sup>123</sup>

Për Byzantinin që të dy këto pjesë kanë ruajtur karakterin e mirëfilltë etnik, me të vetmin ndryshim se *i Larti*, mbërthen edhe një pjesë të Maqedonasve dhe të disa fiseve ilire, të cilat për të, po ashtu, lidhen me bërthamën e vjetër pellazge, por që rrethanat e ndryshme i kanë bërë të ndryshëm nga pikëpamja shoqërore dhe politike. Kjo vlen veçmas për Maqedonasit, të cilët do ta çojnë më tutje idenë e helenizmit si një pasqyrim të fuqisë së madhe pellazge, por pa u kthyer në Helenë.

<sup>122</sup> Më gjerësisht rreth Ilirëve si indoeuropianë klasikë shih: Budimir Millan: “*Iliri i prailiri*”, 1952.

<sup>123</sup> Stefan Byzantini: “*Urbibus et Populis*” (Mbi qytetet dhe popujt). Leksikografi i shquar me prejardhje nga Konstandinopoli (jetoi në shekullin VI të erës sonë), është autor i një leksikoni të madh gjeografik të titulluar “*Ethinka*”. Leksikoni i Stefan Byzantinut ka rëndësi për historinë e Ilirisë mbasi ai na njofton jo vetëm mbi shumë qytete e fise të Ilirisë e të Epirit të njohura dhe nga botime të tjera më të vjetra, por edhe mbi qytete të cilat nuk ndeshen në asnjë nga veprat e ruajtura të shkrimtarëve paraardhës. Po ashtu me interes janë edhe emrat e disa fiseve ilire, të cilat nuk janë përmendur deri më atëherë, që gjenden në atë që ai e quan pellazgjik epirot.

Edhe krahina në të cilën gjendet fathana e Dodonës, që ishte themeluar prej Pellazgëve, quhej Pellazgjia.<sup>124</sup>

Këtë e tregon edhe Herodoti kur shkruan se ky vend, që në kohën e tij quhej Heladë, i takonte Tesprotisë së Tesprotëve të njohur, mbretëria e të cilëve numërohet ndër të parat dhe më të vjetrat e Pellazgjisë.<sup>125</sup>

Kjo dëshmohet edhe me gojëdhënat që tregon Plutarku kur flet mbi Pirron, ku thuhet “se mbas përmbysjes së madhe ka sunduar mbi Tesprotët, ndër më të vjetrit, që kishin ardhur në këtë vend bashkë me Pellazgun”.<sup>126</sup>

Farefisninë e Epirotëve të Lindjes me ata të Perëndimit e dëshmon edhe ajo që thotë Apollodori se si *Tesproti* dhe *Makedoni* janë djemtë e Lykaonit nga Arkadia, i cili ishte bir i Pellazgut<sup>127</sup> dhe sipas Stefan Byzantinit, *Atitani* ishte bir i Makedonit.<sup>128</sup>

Këto dëshmi të ndryshme të antikitetit lejojnë për të nxjerrë përfundimin se edhe Maqedonasit ishin Pellazgë, dëshmi kjo që forcohet edhe më tutje me ato që thotë Eskilit se e gjithë Maqedonia gjendet brenda kufijve të Argidëve. Ai sjell edhe dëshminë e mbretit të tyre i cili thotë:

*“Unë jam Pellazgu, i biri i Palektonit, mbreti i këtij vendi, prej meje, prej mbretit, e ka marrë emrin populli, i cili punon tokat e këtij vendi edhe të gjitha krahinat që përshkon Aksiosi (Vardari) dhe Strymani nga perëndimi. Mbretëria ime përfshin vendin e Perebejve, krahinat e Pindit, ato të Peonëve, malësinë e Dodonës dhe kufiri mbaron te deti. Bile edhe matanë shtrihet sundimi im, por ky vend quhet Apia”*.<sup>129</sup>

Edhe Justini fiset e ndryshme të Maqedonisë së vjetër ose të Ematisë i quan pellazge<sup>130</sup> dhe, sipas Elianit, babai i fiseve pellazge *Lykaoni* ka qenë mbret i Ematisë (Emathia).<sup>131</sup>

Sipas Aristotelit edhe *Botiejt*, që ishin nga Atena (vendi kryesor i Pellazgëve) dhe Kreta (Homeri shkruan se edhe këtu ka Pellazgë) dhe se duke kaluar nëpër Delf dhe Japydi, këndonin se “*Kemi ardhur nga Atena*”.<sup>132</sup>

---

<sup>124</sup> Homeri: “*Iliada*”, libri XVI, 254; Straboni: “*Gjeografia*”, libri VII, 5, faqe 327; Skymnos, v. 450.

<sup>125</sup> Herodoti: “*Historia*”, libri II/56, cituar sipas John Georg von Hahn: “*Studime shqiptare*”, Tiranë, 2009, faqe 16.

<sup>126</sup> Herodoti: “*Pyrrus*”, 1

<sup>127</sup> Apollidori, III, 8, 1.

<sup>128</sup> Eskili (Aeskylos), vargu 249.

<sup>129</sup> Po aty.

<sup>130</sup> Justin, VII 1 (*Macedonia ante, nomine Emathionis regis, Emathia cognominata est. Populus Pelasgi, regia Boetia dicebatur*).

<sup>131</sup> Aeilon, “*De natur. anim.*” X, 48, cituar sipas John Georg von Hahn. “*Studime shqiptare*”, Tiranë, 2009, faqe 299.

Megjithatë, ndërlihdhja e Maqedonasve me Pellazgët si dhe barazimi i tyre i plotë me këtë familje të madhe, në njërën anë nxjerr në pah fuqinë shoqërore dhe politike të tyre në përmasat e gjera, të njohura si Mbretëri Maqedonase, e cila në kohën e Aleksandërit të Madh, në shekullin IV para erës sonë, me shtrirjen deri në Indi, arriti kulmin e famës dhe me të drejtë u quajt botërore dhe, në tjetrën anë, bën me dije se faktori helen si dhe vetë helenizmi nuk do të ishte në gjendje të arrinte shkallën e një zhvillimi të tillë jashtë brumit pellazg dhe fuqisë që përthi-  
thi prej tij në të gjitha aspektet, epigon i së cilës, nga aspekti shoqëror dhe politik, ishte pikërisht Aleksandri i Madh.

Meqë ngritja e Maqedonisë në përmasa botërore ndodhi në kohën e helenizmit klasik dhe rendi shoqëror dhe politik i vendosur prej tij ishte ai që prodhoi po i njëjti helenizëm, me të drejtë hap çështjen e përkatësisë helene të Maqedonasve si etni, siç u shpallën nga filohelenistët e shekullit XIX.

Mbi këtë teori edhe sot shfaqen konstrukte të ndryshme të natyrës politike, ndonëse nga Helenët e mirëfilltë ata merreshin si “barbarë”. Kjo hap edhe çështjen e karakterit të Mbretërisë Maqedonase, së cilës, po ashtu, nga filohelenizmi i shekullit të kaluar, i mohohet çfarëdo autenticiteti, jashtë matricës politike helene. Dihet se Maqedonia ishte një mbretëri autentike-patriarkale me mbretin (Basilueus) kryekomandant ushtarak, kryepriфт dhe gjykatës,<sup>133</sup> siç ishin edhe mbretëritë e tjera nga familja pellazge (dardane, ilire dhe epirote), ndërsa në atë që më vonë do të quhet Greqi, të pushtuar përfundimisht nga Aleksandri i Madh, mbi-zotëronte rendi i polisit: *qyteteve-shtete* (i Spartës dhe i Athinës), të cilat luftonin mes vete dhe hiç më shumë, gjë që Mbretëria Maqedonase e zhvlerësoi.

Megjithatë, ngritja e Mbretërisë Maqedonase nuk mund të shihet jashtë fuqisë së disa fiseve, të cilat jetonin në hapësirën e përbashkët, e njohur me emrin “*Emathia*”. Kjo fjalë, sipas disa interpretimeve, ka të bëjë me natyrën e gjuhës shqipe nga rrënja “*madh, madhe*” prej nga del “*e madhe*”- “*emadhia*” dhe, pas-taj, gjatë shqiptimit mund të ketë marrë edhe trajtën e njohur *Maqedonia*, që si e tillë shfaqet vetëm duke filluar nga epoka klasike.

*Se Emathia* është trajta më e lashtë, këtë na e vërteton edhe Homeri, i cili nuk e njihte fjalën Maqedoni.

Siç mësojmë nga autorët antikë, edhe ajo që më vonë do të quhet *Maqedoni*, përfshinte, si përshkruan Straboni, gjithë fushat nga Aksios (Vardari) dhe Haliak-

---

<sup>132</sup> Shih Straboni: “*Gjeografia*”, libri IV/1.

<sup>133</sup> Shih: Niebuhr, Berthold-Georg: “*Vorträge ber alte Geschichte*”, Bonn, 1830 dhe Curtius, E: „*Griechische Geschichten*“1878.

monon, ku gjendej kufiri me Epirotët dhe Pajonët. Peneu gjendej si kufi me Maqedoninë në veri. Ndërsa edhe Olimpi gjendej në Maqedoni.<sup>134</sup>

Nga burimet historike mësohet se pas Aigeait dhe Edesës, do të jetë Pella, kryeqytet i këtij vendi, i cili gjatë kohës së Filipit II njohu një zhvillim të madh, që nisi pas luftës së Peloponezitet (vitet 431-404 para erës sonë), ndonëse ata edhe më tutje trajtoheshin si barbarë dhe për më tepër jeta shoqërore dhe politike e Maqedonisë nuk pajtohej me Greqinë nga shkaku se në njërin anë kishim mbretërinë (Maqedoninë) dhe në tjetrën polisitet-shtete (Athina, Sparta).<sup>135</sup>

Kështu, Maqedonia u ndërtuar pak nga pak nga pushtimet deri te aneksimet, por që mbretëria u helenizua shumë më shpejtë se sa populli ngaqë ishte gjuha greke si dhe rendi shoqëror që mundësuan këtë në raport me pretendimet për zgjerimin e pushtetit në drejtim të jugut për të vazhduar pastaj në lindje. Andaj nuk është e rastit që hovi i fuqisë së Mbretërisë Maqedonase filloi pikërisht në vitin 338 para erës sonë, në betejën e Kreones, kur Aleksandri i Madh pushtoi polisitet-shtete, të cilave formalisht ua njohu rendin e poliseve si dhe strukturat qeverisëse, të cilave ua vuri sipër kurorën e Mbretërisë Maqedonase, prej nga pastaj do të kalojë në Lindje, duke pushtuar një nga një mbretëritë dhe perandoritë e kohës.

Edhe pse ngritja dhe nami i madh i Mbretërisë së Maqedonisë të shumtën shfaqet i lidhur me Heladën dhe me helenizmin shpesh duke u identifikuar me të, megjithatë edhe forma më e njëanshme e këtij përvetësimi historik, nuk mund të fshehë origjinën pellazge-ilire të Maqedonasve, siç nuk mund të fshehë as të dhënen se Maqedonia ishte një entitet ndryshe nga ai helen, që edhe në rrethanat kur Aleksandri i Madh gjuhën greke e pranoi si gjuhë zyrtare perandorake dhe me anën e saj la dëshmi të pashlyeshme, po nga autorët antikë dhe të tjerët vazhdoi të shihej “ndryshe”, pra “si barbare”, që jo vetëm nuk hoqi dorë nga gjuha amtare, por, thuhet se nga brenda, e ruajti edhe si gjuhë të komandës ushtarake. Kjo, nga pikëpamja filologjike, ngriti çështjen e gjuhës së mirëfilltë maqedonase si dhe të origjinës së saj, që meqë nuk ishte greke, gjithsesi duhej të vinte nga familja “barbare”, pra nga ajo pellazge.<sup>136</sup>

Disa emra dhe toponime nga hapësira e Maqedonisë antike (Emathias), që jo rrallë i ndajmbathen edhe gjuhës maqedonase, siç janë *Peleo*, *Olimp*, *Osa*, *mal* dhe të tjera, emra dhe toponime që i ka përvetësuar edhe greqishtja e vjetër, si të

<sup>134</sup> Shih Aref, Mathieu: “Mikenët=Pellazgët”, Tiranë faqe 492.

<sup>135</sup> Shih Jarde, A : “La formation du peuple grec”, Paris 1923, faqe 394.

<sup>136</sup> Shih Plutarku: “ τοις Ελλησι τοις Μκεδοσι” (Jeta e Plutarkut); J. Baptis. Croph. “Lingua macedonicam peculiari dialecto a reliquis graecae linguae distinctam fuisse dubium non ist – Gjuha maqedonase nuk ka dyshim që është e ndryshme nga dialektet e tjera të gjuhës greke”, “Antiquitates Macedonia”, libri 2, kreu V.

tillë nga shumë paleofilologë trajtohen si pellazge ose të leksikut të vjetër para-indoeuropian, parahelen e ndryshe me çka tumiren pikërisht njoftimet e përmendura më lart që na vijnë nga autorët antikë rreth përkatësisë së maqedonasve familjes së madhe dardane-ilire-epirote të dalë nga trugu pellazg.

Kështu, sipas Xh. Krispit, rajoni *Pella* në Maqedoni e lashtë, ku lindi Aleksandri i Madh, lidhet me fjalën e vjetër *Pela – pelë*, që mund ta ketë marrë ngaqë ka rritur pela (kuajt) të njohura, prej nga ka origjinën edhe kali i njohur Bucefalo i Aleksandërit.<sup>137</sup>

Ka edhe shumë e shumë fjalë të tjera, nga maqedonishtja e vjetër, të cilat Krispi i lidh me shqipen, me anën e të cilave, në mos tjetër, atëherë tumiren dëshmitë e shumta që na vijnë nga autorët antikë rreth dallimeve midis Maqedonasve dhe Grekëve si dhe afritë midis Maqedonasve dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes ilire, ku ata të shumtën shihen prej nga del edhe qëndrimi se maqedonishtja dhe greqishtja ishin dy gjuhë të ndryshme.<sup>138</sup>

E dhëna që Maqedonasit dhe Helenët flisnin gjuhë të ndryshme, Hahnit ia zgjuan edhe më tepër hamendjen se gjuha maqedonase mund të ishte një e folme pellazge. Kjo i erdhi nga krahasimi që u bëri disa fjalëve të vjetra maqedonase, të klasifikuara nga filologu G. Sturzii,<sup>139</sup> të cilat kanë pika afrie me shqipen dhe assesi me greqishten e vjetër. Ndër të tilla përmenden fjalët *λίσσον, τοθψμλου* “i lartë”= shqip *lis-i* vendoset ndaj saj ashtu si lat. *Arbar* ndaj kelt. *Alb* - “i naltë”; *αραπανοι* – *përrua* (*shqip*); *γοδα* – *sorra* (*shqip*); *γοτον* – *derr* (*shqip*); *γραωιον* – *dritë* (*shqip*) e të tjera.<sup>140</sup>

Bredhja nëpër shënimet e autorëve antikë, veçmas ajo që ka të bëjë me raportet e Maqedonasve të vjetër me Helenët, nuk ka për qëllim të nxjerrë në pah vetëm atë që leksikoni i njohur i Stefan Bizantinut para pesëmbëdhjetë shekujsh e paraqet si një faktografi autentike të kohës, që shkon në thellësi edhe për pesë-gjashtë shekuj të tjerë, por për të pasqyruar realitetet historike mbi të cilat është ngritur etnia që ka dalë nga rrënja pellazge, e cila nuk ka qenë as e shkëputur e as jashtë realiteteve, siç mund të shihet nga vrojtimit e anshme. Ajo shfaqet edhe më komplekse për shkak se degët e saj shtrihen në një hapësirë etnogjeografikisht të lidhur nga Europa Qendrore nëpër gjithë Gadishullin Ilirik e në Azi të Vogël për t’u hapur pastaj edhe në pjesët e tjera

<sup>137</sup> Shih Plutarku “*Jeta e Aleksandërit*”, cit. sipas Krispi, Xhuzepe “*Shqipja nënë e gjuhëve*”, Tiranë 2009, f. 51.

<sup>138</sup> Shih: Polibi XVII: “Tre popujt: Eolet, Akarmanët dhe Maqedonët flasin të njëjtën gjuhë, por kjo nuk ishte greqishtja”.

<sup>139</sup> Shih Struzii, F. G: “*De dialecto Macedonia et Alexandrina*”, libri 8.

<sup>140</sup> Shih Hahn, J. G von: “*Studime shqiptare*”, Tiranë 2009, faqe 308.

të Mesdheut, veçmas në drejtim të Italisë, ku më e rëndësishmja është ajo që ka të bëjë me Etruskët (Tyrrenët), enigma e të cilëve ka preokupuar shumë shkencëtarë, që sa më e pazgjidhur që është dukur, se ai popull i vjetër nuk ka treguar kurrfarë ngjashmërie as vëllazërie me Grekët, Italikët, Gotët, Balto-Sllavët dhe të tjerët, në të vërtetë, çështjen e ka kthyer te Pellazgët, pikërisht siç ka bërë të ditur Homeri kur në *Iliadë* do të tregojë për Trojanët (kryesisht Dardanët), që do të kapërcejnë detin dhe do të shkojnë në Itali për ta zhdëmtuar me diçka (me Romën) Trojën e humbur, ose siç do ta rikëndojë këtë histori edhe Virgjili te “Eneida”.

## MBRETËRI E MAQEDONISË GJATË KOHËS SË FILIPIT II

Në trekëndëshin historik të mbretërive dardane-ilire-epirote, të cilat mbështeteshin në shoqëritë fisnore prej nga si etnose të bashkuara ngriheshin deri te përmasat e dinastive, një vend të veçantë zënë edhe ato maqedonase, me origjinë nga familja mbretërore e Termenidëve, pinjojtë e të cilëve u vetëquajtën “Argeadë”,<sup>141</sup> pasardhës të Argeasit, të cilin burimet mitike e nxjerrin bir të Macedoninit, pasardhësit të Zeusit. Por, edhe në epokën historike, trangu mbretëror maqedonas shihet i lidhur me mbretërit mitikë të Argosit, ndër të cilët, i pari ishte Argeu, në shekullin VII, para e.r. Pastaj vjen Amniasti I, vasali i Dariusit të parë. Pas tij vjen Aleksandri I, i ndjekur nga Alketa II, i fundit i kësaj dinastie. Por, Aleksandri I njihet si baba i dinastisë së re maqedonase ku, i biri, Predika II, merr në dorë mbretërinë, më 448. Pas tij vijnë: Arkesos dhe Arkesosi II, edhe kjo rrënjë shuhet me Orestin dhe fillon Dinastia tjetër e re që vjen direkt prej Aleksandërit I, me ardhjen në fron të të birit, Amintasit I, më 454 para e.r. Pas tij vjen Aminta II, i cili martohet me princeshën ilire, Euridikën dhe lindin Aleksandërin II, Predikë II dhe Filipin II. Këta tre pra ishin ilirë nga e ëma Euridika. Dy te parët u vranë, ndërsa Filipi II, nip iliri, u martua me një princeshë dardane nga rrënja e Bardhylit dhe lindi një djalë, 10 vite para Aleksandërit, por pastaj u martua edhe me Olimbinë e Molosëve. Nga kjo martesë sheh dritën Aleksandri i Madh. Nga kronologjia e mbretërve të fundit, del se Filipi II dhe Aleksandëri III apo Aleksandri i Madh janë me prejardhje dardane-ilire. Bie në sy se mbretërit e Maqedonisë së vjetër nuk

---

<sup>141</sup> Shih: Hammond, N. G. L. : “*A History of Macedonia*”, 1981, faqe 481.



patën asnjë lidhje gjaku përmes martesave më Helenët por vetëm me Dardano-Ilirët.

Përkundër gjenealogjisë së mbretërve maqedonas dhe lidhjeve të tyre me familjet mbretërore dardane-ilire që ishte e natyrshme në ato rrethana, ngritja e Mbretërisë së Maqedonisë në fuqi rajonale dhe më vonë në kohën e Aleksandërit të Madh në atë botërore, krahas kësaj, është e lidhur ngushtë me Greqinë dhe zhvillimet në të, të cilat, sidomos me ato që kanë të bëjnë me kapërcimin nga koha klasike te ajo e helenizmit në shekujt V-IV, që si e tillë ishte e përcjellë në një anë me krizën e poliseve-shtete greke dhe në tjetrën me fuqizimin e Mbretërisë së Maqedonisë me në krye Filipin II, pasi që ai erdhi në pushtet më 359. Këto zhvillime me kahe të kundërta, megjithatë i hapën rrugë një procesi të pandalshëm historik, ngaqë Maqedonia, nën drejtimin e Fillipit II hap pas hapi, pasi që zgjidhi shumë problemet me fqinjët e veriut (i mundi Ilirët dhe ua mori tokat deri te Ohri) si dhe i shfuqizoi dinastitë lokale (të Elimejve, Linkesidit dhe të Orestidit), pasi që të ketë forcuar ushtrinë me krijimi e njësisive të falangës dhe unitetin e brendshëm të shtetit, iu drejtua pjesëve të Trakisë, ku prekeshin interesat e Athinës. Kështu, në vitin 357, pushtoi Amfipolin në Traki (koloni athinase në deltën e Strimonit) dhe i hapi rrugët për te mali i Paganjit. Më 356 pushtoi Potidejen. Këto veprime Athina dhe gjithë Greqia i pa si shenja të qarta të zgjerimit të hegjemonizmit maqedonas drejt tyre. Veçmas, ato që u përcollën me pushtimin e Halkidikit. Pas pushtimit të qytetit Olint, Trakasit u detyruan të nënshkruajnë paqe me Filipin II, me ç'rast u pranua pushteti i Maqedonisë në Tesali dhe pjesët e tjera, gjë që i detyroi athinasit që në vitin 346 të lidhin paqen e Filokratit. Me këtë paqe Filipit II iu pranuan të gjitha pushtimet nga Trakia e deri në Termopile.<sup>142</sup>

Paqja e Filokratit pati jehonë të dyfishtë: te Maqedonasit, të cilët tashmë ndjeheshin fuqi që mbante në dorë përgjegjësinë që Maqedoninë dhe Greqinë ta lironte nga trysnia e Persisë në lindje dhe të poliset-shtete greke (Athina, Sparta) që të pranojnë hegjemoninë maqedonase, duke iu përshtatur asaj në mënyrë që fuqinë e fqinjit verior ta shfrytëzojnë edhe për konsolidimin e brendshëm por edhe për qërimin e hesapeve me persët. Natyrisht se në këtë drejtim, Filipi II, shfaqej i kujdesshëm ndaj Athinës, e cila ishte një fuqi detare po edhe ndaj të tjerëve, në mënyrë që hegjemonia e tij në atë pjesë, të mos dukej si pushtim klasik, po si një marrëveshje e ndërsjellë në përputhje me qëllimet e përbashkëta,

---

<sup>142</sup>Papazoglu, Fanula: "Istorija helenizma – Epoha Aleksandra Velikog", Beograd 1970, faqe 40-41.

ndër të cilat, gjithsesi lufta kundër Persisë ishte ajo që i bashkonte. Për ta forcuar këtë bindje, Filipi II, në vitin 338, thirri në Korint mbledhjen e një Kongresi me përfaqësuesit e të gjitha njësisve të pavarura greke për t'u dhënë vijë marrëdhënieve të ndërsjella (atyre midis poliseve-shtete helene) me Maqedoninë. Në këtë kongres, Filipi II ua diktoi paqen përfaqësuesve të qyteteve greke në formën e një marrëveshjeje të përgjithshme dhe të qëndrueshme, siç e quajti, që do të ishte e dobishme për të gjithë. Me këtë marrëveshje paqeje, Filipi II ia doli të krijojë një raport të veçantë me poliset-greke: që me lidhjen e një aleance ushtarake, praktikisht të vihet mbi to, por në të njëjtën kohë të ruajë edhe statusin autonom të tyre.<sup>143</sup> Kështu që, marrëveshja e Korinthit ishte një fitore për vetë grekët dhe raportet e shthurura midis poliseve-shtete, ngaqë ato eliminuan luftën e ndërsjellë, që i përcillte thuajse vazhdimisht, ndërsa siguruan autonomi dhe liri në raport me njëri-tjetrin, që do të pasqyrohej në marrëdhëniet e gjithmbarshme, veçmas me ato të lirimit të lirë nëpër ujërat detare, që shfaqeshin si shkak i luftërave të vazhdueshme midis tyre. Kjo do të pasqyrohet edhe me marrëveshjet e ndërsjella të poliseve-shtete pas pak, siç ishin ajo e Athinës me Spartën në vitin 375, që kishte për pikënisje krijimin e një aleance kundër Tebës. Roli i Filipit II në këtë proces ishte i madh dhe vendimtar, ngaqë detyroi paqen e brendshme midis poliseve-shtete helene, me ç'rast ato në njëfarë mënyre u bashkuan mbi interesa të përbashkëta, ndërkohë që në mënyrë indirekte vendosi hegjemoninë maqedonase mbi Greqinë, mbi konceptin e njohur të "unitetit me ruajtjen e ndasive".

Kjo hegjemoni, e para e llojit të tillë, kishte ndikim të madh te zhvillimi i helenezimit dhe vënia e tij në binarët e një lëvizjeje, që si do të shihet, pas pak, me ardhjen e Aleksandërit të Madh në pushtet, do t'ia hapë rrugën Perandorisë Botërore, si një model universal të njësimin të botës maqedonase-greke me atë të lindjes.

Roli dhe vendi i Filipit II në këtë zhvillim jo vetëm që është vendimtar, por me të drejtë, merret edhe si më i rëndësishmi, që në shumë raste vlerësohet kyç, madje më i madh se i Aleksandërit, ngaqë ia krijoi strukturën, konceptin e mbi të gjitha rrethanat politike dhe shoqërore këtij zhvillimi historik.

Kur thuhet kështu kihet parasysh dy momente të rëndësishme: korniza e hegjemonizmit maqedonas në raport me atë grek, duke i ndërlidhur mes veti forcat

---

<sup>143</sup>Rreth Marrëveshjes së Korinthit shih: Wilhelm, A: "Attische Urkunden I: Urkunden des korinthischen Bundes", Wien 1911, faqe 165; Willken, U: "Beiträge zur Geschichte des korinthischen Bundes", München 1917, faqe 10; Schwahn, W: „Heresmatrikel und Landfriede Philippes von Makedonien“, Beith, 1930, faqe 21, Schehl: „Zum korinthischen Bund v.j.338-7 v.chr“, Jahreschrift d.österreichischen archäologischen Institut, Wien, nr.21- 1930.

diverse të polisve-shtete, si dhe ideja e një lufte kundër Persisë, që kishte konsensus të përgjithshëm dhe madje ishte motivuese për të gjitha shtresat shoqërore, duke përfshirë edhe filozofët (Isokratin, Aristotelin e të tjerë), të cilët, ndaj hegjemonisë së Filipit II kishin “mirëkuptim” te pikëpamja se ai duhej të merrte përsipër luftën kundër Persëve, gjë që mund të pranohej nga bota helene në këtë rol.

Në të vërtetë, këtu dhe te kjo çështje, jeta politike dhe shoqërore greke, do të fitojë impulse të reja, me të cilat ajo do të kapërcejë ankthin e ngufatjes nga luftërat e brendshme drejt një çlirimi të jashtëm, natyrisht hegjemonist në raport me Persinë. Njëri ndër ata që do të hapë publikisht dhe do ta mbrojë hegjemonizmin maqedonas në raport me Greqinë do të jetë Isokrati, i cili në fjalimin e tij të njohur “Philippos”, gjithë çështjen do ta shikojë në prizmin e “bashkimit grek”, të idesë, e cila, politikën do ta kthente kah universalizmi dhe jo destruksionet e brendshme të luftës për pushtet, siç ndodhte në ato rrethana kur Athina dhe në përgjithësi demokracia greke, ndodhej para një krize të thellë ngaqë nuk ishte në gjendje t’u jepte përgjigje shumë çështjeve të hapura ndërkohë që “shpëtimi” kërkohet nga konfliktet me fqinjët paçka se kjo pasqyrohej në dobësimin e asaj që merrej si “botë e lirë greke”. Isokrati doli haptas në mbrojtje të idesë së bashkimit grek nga ana e Filipit II me kusht që të merrte përsipër edhe luftën kundër Persisë. Në një letër drejtuar Filipit II Isokrati kërkonte një kurorë të trefishtë për të: së pari të mirëbërësit të Herladës, pra që t’i ndihmohej nga brenda që të përballonte krizën e thellë shoqërore dhe politike, atë të mbretit të Maqedonisë, pra që modeli monarkik, që Demosteni dhe të tjerët e shikonin si një rrezik për lirinë dhe demokracinë, të mbetej vetëm në kuadër të hapësirës maqedonase, dhe despot të barbarëve, pra që atyre t’u parandalohej çfarëdo mundësie, të ndikojnë në jetën shoqërore dhe politike të grekëve.<sup>144</sup>

Me këtë mendim të Isokratit, pra që Mbreti i Maqedonisë të jetë hegjemon për grekët, në kuptimin e një bashkimi politik të tyre, por pa u prekur strukturat autonome të polisve-shtete dhe, despot për barbarët (mendohej për Ilirët, Dardanët dhe të tjerët në veri), do të pajtohet edhe Aristoteli, edhe pse as publicisti i njohur dhe filozofi i madh, mësues i të birit, Aleksandërit, nuk ishin të bindur se ai do të mund t’i hiqte dallimet midis grekëve dhe barbarëve, nga fakti se ai vinte nga ajo botë, por që hegjemonizmi maqedonas si një qendër e fuqishme

---

<sup>144</sup>Shih: Peleman, S: “*Isocrates Philippus, a Reinterpretation, Historia*”, 1957, faqe 306; Stroheker, K. F: “*Zu den Anfängen der monarchischen Theorie in Sophistik*”, 1952, faqe 318; Wilcken, U: “*Philipp II von Makedonien und die panhellenischen Idee*”, Berlin, 1929;

shoqërore dhe politike, do të ishte e dobishëm për barbarët që të lirohen nga despotizmi po qe se jetojnë në rrethanat e një shoqërie greke.

Të menduarit filozofik dhe politik grek rreth hegjemonizmit maqedonas dhe misionarizmit të tij në rrethanat kur Filipi II thajse ua kishte krijuar kornizën shtetërore dhe atë ushtarake dhe ndodhej në lëvizje, që u pasqyruan me dërgimin e një ekspedite ushtarake në Atala të Azisë së Vogël për të hyrë në luftë me Persët, sikur u qëllua dhe madje u duk një “iluzion” çastin që Filipi II u vra nga Pauziani, në një atentat me rastin e martesës së të bijës Kleopatra, në shenjë të një hakmarrjeje.<sup>145</sup>

Por, si do të shihet, vepra e Filipit II, e ndërtuar gjatë njëzet e katër vjetësh qeverisjeje, me ç’rast ai ia doli që mbretërinë e Maqedonisë, nga një despotat i rëndomtë, ta kthejë në fuqinë më të madhe të Ilirikut, ku do të bashkojë edhe helenët dhe poliset-shtete brenda një sistemi, pa ua prekur fare autonominë dhe strukturat e tyre shoqërore dhe politike, nuk do të rrënohet, edhe pse ajo do të kundërshtohet së pari nga poliset-shtete helene, pikërisht nga ata që shpresonin se mund t’u ndihmonte më së shumti. Përkundrazi, do të jetë i biri, Aleksandri i Madh, i cili do të vazhdojë veprën e të atit, duke i dhënë dimensionin e një perandorie botërore, ndër më të fuqishmet dhe ndër më të qytetëruarat e botës.

## MBRETËRIA MAQEDONE NË KOHËN E ALEKSANDËRIT TË MADH

Pika kulmore e historisë së Maqedonisë antike ka të bëjë me Aleksandërin e Madh (356-323 para erës sonë),<sup>146</sup> vend ky në veri të hapësirës kulturore greke, i konsideruar “barabar” prej tyre, të cilën ai e ktheu në një perandori botërore. Por, siç u pa, para se të arrinte këtë, Maqedonia ishte e përfshirë në lufta të vazhdueshme me rivalët ilirë, dardanë dhe epirotë. Krahas kësaj, në kuadër të përpjekjeve për të shtrirë pushtetin, midis shekujve VI dhe V, mbretëria maqedonase u përqendrua për të nënshtruar, por jo edhe pushtuar, poliset-shtete greke (Athinën dhe Spartën), me ç’rast shfrytëzoi edhe luftërat persiane (500-448 para erës

<sup>145</sup>Shih: Wust, F.R: “*Philipp II von Makedonien und Griechenland in den Jahren von 346-338*”, München 1938; Chopoit, V: “*Filippe II de Macedonie*”, Paris, 1936.

<sup>146</sup> Aleksandri i Madh lindi në vitin 356, si biri i mbretit Filipi II nga Maqedonia dhe mbretëresha Olimpia, e bija e mbretit të Molosëve. Plutarku thotë se ai kishte bindjen se ishte bir i Zeusit. Pavarësisht legjendave, për fëmijërinë e Aleksandërit dihet pak. Ajo që megjithatë dihet, ka të bëjë me atë se i ati, Filipi II, sollti në oborr filozofin Aristotel për ta arsimuar të birin në matematikë, filozofi dhe art. (Shih: Arrianus, Flavi Lucius: “*Alexandri ananasis Continens*”, libri I-III, Lipsiae, Teubner, 1907).

sonë), që në një aleancë me mbretin Dari I të arrijë këto qëllime. Pas përfundimit të luftërave persiane, në të cilën Maqedonia luftoi në anën persiane, mbreti maqedonas, Aleksandër i Maqedonisë, i siguroi një pozitë të volitshme në raport me polisët-shtete helene, paçka se edhe aleancat dhe lidhjet me to nuk ishin asnjë-herë pa telashe që shkonin edhe deri te luftërat e shumta, siç ishte edhe ajo e Pe-loponezit (431-404 para erës sonë) dhe ajo kur Potidaia u largua nga Lidhja e Peloponezit, mbreti maqedonas Perdika II, mbështeti këtë qytet dhe qytetet e tjera të Halkidisë, me çka u fut në konflikte të reja me Athinën, të cilat u mbështetën nga vëllai i Perdikës, Filipi. Pak më vonë, megjithatë, Maqedonia dhe Athina u bashkuan në një aleancë të re.

Ardhja në pushtet e Aleksandërit të Madh, ndonëse dukej e parakohshme, ngaqë u desh ta merrte fronin e të atit të vvarë, mbretit Filipit II, kur në vitin 336 para erës sonë u vra në kryeqytet nga një roje gjatë ceremonisë së martesës së të bijës, Kleopatrës me mbretin e Epirit, Aleksandërin, ajo në të vërtetë, paraqet kthesën më të madhe historike të ngritjes së Maqedonisë në një mbretëri, që ia doli të kalojë kufijtë e botës ilire-greke në të cilën ndodhej prej më se tre shekujsh për të arritur atë të një perandorie botërore.

Ngritja te përmasat e perandorisë botërore, Maqedoninë e çonte në drejtim të Lindjes, fillimisht për ta mundur kundërshtarin kryesor - Persinë, prej nga do të shkojë tutje deri në Indi. Perandoria e tij po ashtu, u shtri edhe në Egjipt, ku edhe u kurorëzua perandor dhe me këtë arriti përmasat e perandorisë botërore, ndër më të mëdhatë e kohës, me karakter kozmopolit, ngaqë krahas përhapjes së helenizmit, ajo përhapi edhe qytetërim ngado shkoi, gjurmët e të cilit i mbijetuan kohëve.

Para se të niste rrugën e triumfit më të madh deri atëherë në historinë e njerëzimit, Aleksandri i Madh, më 336 para e.s. ndonëse i ri dhe pa përvojë, u desh ta forconte pushtetin e trashëguar nga i ati i vvarë. Brenda një viti ia doli të sigurojë Lidhjen e Korinthit, duke bërë me dije se ajo nuk ishte vetëm marrëveshje e paqes siç kuptohej nga disa, që kishin filluar ta kundërshtonin, por një aleancë politike-ushtarake që drejtohej nga mbretëria maqedonase, e cila për qëllim kishte luftën kundër Persisë. Natyrisht, se për ta rikthyer besimin që kishte filluar të humbej pas vrasjes së Filipit II, Aleksandri i Madh, u desh ta përdorë forcën ndaj disa pjesëve në Thesali dhe Greqi të Mesme, që kishin filluar të deklaroheshin “të pavarura” ndaj Lidhjes së Korinthit. Veprimet e ashpra të Aleksandërit të Madh në këto pjesë, si dhe demonstrimi i gatishmërisë që ajo të mbrohej me mjete ushtarake, detyroi Delfin, Athinën dhe qytetet e tjera të pranojnë hegjemoninë e Maqedonisë. Kjo ndodhi në një takim të Lidhjes në Korinth, në të cilën,

Aleksandri, u prit me nderime dhe iu dha besimi për të filluar fushatën luftarake kundër Persisë.<sup>147</sup>

Fitorja ndaj grekëve në Korinth kërkonte ridëshmimin e pushtetit mbretëror edhe në pjesën veriore, në Traki dhe ato të Ilirisë, të përfshira në mbretëri nga Filipi II, se kishin shpërthyer kryengritjet. Kështu, në pranverën e vitit 335, Aleksandri i Madh ishte detyruar të niste një fushatë ushtarake fillimisht kundër Tribalëve në veri e më pas kundër Ilirëve në pjesën qendrore.

Siç dihet, Tribalët ishin njëri ndër fiset më të fuqishme të Ilirikut verilindor, hapësira etnike e të cilëve, sipas Herodotit dhe Turkididit, shtrihej përgjatë Moravës jugore dhe perëndimore deri në perëndim të lumit Iskera (Danubit).<sup>148</sup> Po sipas shumë autorëve antikë, Tribalët shiheshin “degë ilire”, që flisnin “të njëjtën gjuhë”,<sup>149</sup> por që etnia e tyre ishte ndarë në përputhje me strukturat shoqërore dhe politike që ishin ngritur gjatë mbretërisë së Dardanisë, asaj të Trakisë dhe të ngjashmëve në këtë pjesë, gjë që në përputhje me këto ndryshime nga disa autorë shihen edhe Trakas, e herë si përzierje “autonome” dardane-trakase.<sup>150</sup>

Pavarësisht këtyre kundrimeve që nuk e mohojnë fuqinë e Tribalëve në këtë pjesë gjatë antikitetit, sidomos në kohën e ngritjes së Mbretërisë së Maqedonisë si fuqi që do të shpërthejë nga mbërthimi i Ilirikut tutje në Azi të Vogël, në Persi e Indi dhe në pjesën afrikane të Mesdheut, Aleksandri i Madh marshoi në këto pjesë me 15 mijë ushtarë, me ç’rast, pasi e kapërceu Danubin, shtypi revoltën në Traki dhe prej andej, pasi kapërceu malet e Ballkanit u fut në mbretërinë tribale, prej nga pastaj do të qëronte hesapet edhe me Ilirët.<sup>151</sup> Te lumi Lygina pati betejën kryesore me Tribalët, të cilët i mundi, në saje të një mashtrimi, kur një pjesë të fëmijëve të strehuar të Tribalëve, i kishte vënë para njërive të veta drejt pozitive të Tribalëve.<sup>152</sup>

---

<sup>147</sup>Wilcken, U: “*Aleksander der Grosse und der Korintische Bund*”, Berlin 1922, faqe 97-118.

<sup>148</sup>Rreth shtrirjes së Tribalëve dhe mbretërisë së tyre shih te: Arrianus, Flavi Lucius: “*Historia Successorum Alexandri*” te “*Scripta Monoare et fragmente*” S, a, 7 te “*Ilirët dhe Iliria te autorët antikë*”, Prishtinë, 1979, faqe 239 dhe Herodotus: “*Historien*” te “*The Cambridge ancient history. The prehistory of the Balkan*”, faqe 837; Vulić, N: “*Die Sitze der Triballer zur Römerzeit*”, te „Wiener Studicen“, 24-1902;

<sup>149</sup>Chalkondyles, Laonikos: “*Demonstrations of Histories*”, I, Athen, 1996, faqe 23-24.

<sup>150</sup>Papazoglu, Fanula: “*Istoria helenizma*”, faqe 78 dhe Stojić, Milorad: “*Tribali u arheologiji i istorij-skim izvornima*“, 217.

<sup>151</sup>Rreth fushatës së Aleksandri të Madh kundër Tribalëve dhe Ilirëve shih: Arrianus, Flavi Lucius: “*Aleksandri Anabasis*”, libri i parë, kapitulli 4, pika 1. Vulić, N: „*Aleksander Zug gegen die Triballer*“, 1909, faqe 40; Beloch: „*Griechische Geschichte III-2*“, f. 352.

<sup>152</sup>Rreth marrjes së fëmijëve të Tribalëve peng dhe përdorimit të tyre si pararojë në fushëbetejë shih te Arriani, Flavi I “*Aleksandri Anabasis*”, libri I, kapitulli 6, ku përshkruhet tërheqja e Tribalëve në anën tjetër, në pjesën e pusisë që ua kishte vënë Aleksandri i Madh.

Për t'i kursyer fëmijët dhe sipas një marrëveshjeje me maqedonasit, luftëtarët tribalë ishin tërhequr në pjesën tjetër të pyllit, ku kishin rënë në një pusi që ua kishte përgatitur Aleksandri. Përkundër kurthit dhe pabesisë, Tribalët kishin bërë një rezistencë të madhe, por falanga e Aleksandërit kishte qenë e pamëshirshme. Për t'i ikur masakrës, mbreti tribal Sirmos, kishte urdhëruar tërheqjen. Aleksandri i Madh iu kishte vënë pas mbretit tribal. Por nuk ia doli që t'i qërojë hesapet me ta, ngaqë, në anën tjetër të Danubit, ndeshi ushtrinë e Gotëve, të cilët ishin nisur për t'i ardhur në ndihmë mbretit tribal, Sirmos. Në të kthyer, takoi përfaqësuesit tribalë dhe të fqinjëve të tyre trakas që i kërkonin miqësi. Aleksandri pranoi ofertën e tyre dhe lidhi paqe me Tribalët dhe Trakasit në formën e një aleance.<sup>153</sup>

Gjatë kësaj fushate, bëhet e ditur se Aleksandri i Madh priti edhe një mërgatë të “Keltëve nga Adriatiku”, që sipas Ptolemeut paraqet informatën e parë të përmendjes së Keltëve në Ilirik.<sup>154</sup>

Pas paqes me Tribalët dhe Keltët, Aleksandri i Madh, gjatë kohës që po vazhdonte fushatën kundër Pajonëve, pati njoftime se njëri ndër fiset më të fuqishme në brendi të Ilirikut, Autoriatët, po bëheshin gati ta sulmonin ushtrinë e tij gjatë kthimit. Për t'i ikur ndeshjes me Autoriatët, te pjesa e epërme e Strumës, Aleksandri pati një takim me mbretin e Agrijanëve, Longarin, me të cilin kishte marrëdhënie të mira. Nëpërmes tyre arriti një marrëveshje me Autoriatët që të kalojë nëpër tokat e tyre drejt jugut pa u sulmuar ushtria e tij prej tyre.<sup>155</sup>

Pas kësaj marrëveshjeje, nëpërmes Peonisë dhe Pelagonisë, Aleksandri duke ecur anës së lumit Erigon iu drejtua Pelionit, qytetit më të fortë në vend që e kishte pushtuar Kliti. Te lumi Eordaj, Aleksandri ngriti mbrojtjen dhe vendosi të nesërmen të sulmojë qytetin. Sipas Arrianit, Kliti kishte përgatitur një mbrojtje të dyfishtë: brenda mureve të qytetit dhe jashtë nëpër kodrina, gjë që Aleksandri e kishte të vështirë të luftonte në të dy anët. Edhe këtu, Aleksandri kishte përdorur një kurth dhe një mashtrim, si edhe me Tribalët. Por këtë herë, mashtrimin e kishte bërë me disa njësite që kishte futur brenda qytetit, për të inskenuar ikjen, ndërkohë që do t'i sulmojë forcat e Klitit në kodrina, të cilave u kishte ardhur në ndihmë edhe Glauku i Taulantëve. Dredhia kishte pasur sukses, dhe Aleksandëri

---

<sup>153</sup> Arrianus, Flavi Lucius: “*Alexandri Anabasis*”, libri i parë, kap. 4, pika 6 te “Ilirët dhe Iliria te autorët antikë”, Prishtinë, 1979, faqe 234-235.

<sup>154</sup> Papazoglu, Fanula: “*Istoria helenizma*”, faqe 78.

<sup>155</sup> Arrianus, Flavi Lucius: “*Alexandria Anabasis*” te “*Ilirët dhe Iliria te autorët antikë*”, Prishtinë, 1979, faqe 234-236;

kishte sulmuar Ilirët në kodra, kur ata thuajse i ishin dhënë kremtimit të fitores. Aty Aleksandri i Madh mundi Ilirët. Mbreti Klit kishte ikur te Glauku.<sup>156</sup>

Në Iliri, Aleksandri nuk u ndal shumë, meqë dinte edhe për një kryengritje të ngjashme në Greqi, e cila kishte marrë hov gjatë fushatës që kishte kundër Tribalëve në veri.<sup>157</sup>

Qendra e kryengritjes ishte Tebe, e cila ndër të parat ishte hedhur kundër Maqedonisë. Kryengritja u inspirua nga Demosteni, një kundërshtar i flaktë i Maqedonasve, si dhe nga një lajm i remë se Aleksandri ishte vrarë në luftë kundër Tribalëve, që kishte marrë dhenë në atë pjesë. Në Kadme, Aleksandri u përpoq që të arrinte një marrëveshje me tebanët, në mënyrë që t'i bashkoheshin marrëveshjes së Korinthit. Por ata nuk e pranuan. Në betejën kundër tebanëve në Kadme, Aleksandri i Madh përdori njësitë e njohura "Falangën", e cila masakroi mbi 6 mijë kryengritës. Fatin e Tebës, Aleksandri i Madh e la në duart e sinedrionit - lidhjes ushtarake të Korinthit, me ç'rast qyteti thuajse u shkatërrua i tëri, ndërsa 30 mijë qytetarë u kthyen në robër. E kursyer mbeti vetëm shtëpia e poetit Pindar.<sup>158</sup>

Masakra e Tebës shtyri Athinën dhe të tjerët që t'i nënshtrohen Aleksandërit të Madh, i cili, nuk ndërmori ndonjë veprim ushtarak ndaj Athinës dhe fqinjëve të saj, përkundër fushatës së madhe antimaqedone që kishin zhvilluar gjatë kohës sa ai gjendej në luftën me Tribalët dhe Ilirët. Përkundrazi, siç veproi edhe i ati, Filipi, pranoi paqen me Athinën si dhe "pajtimin" me ta, ngaqë qëllimi i tij nuk ishte pushtimi dhe as nënshtimi i grekëve, por futja nën kurorën e mbretë-risë së tij si njësi autonome, gjendje kjo që do të pranohet edhe nga grekët, gjithnjë nën justifikimin se hegjemonia maqedonase i shërbente luftës kundër Persë-ve, që për grekët, shfaqej si çështje e çështjeve.

Në frymën e këtyre zhvillimeve, që do ta forcojnë pushtetin e Aleksandërit të Madh, duhet parë edhe fushata ushtarake e tij kundër Persisë, që do të kthehet në një rën ndërluftë më të mëdha në historinë e njerëzimit. Ajo, megjithatë, kishte edhe prelude e domosdoshëm, të kalimit të ushtrisë së Aleksandërit të Madh në pjesën e Azisë së Vogël, andej ku prej kohësh gjendeshin pjesë greke të

---

<sup>156</sup> Po aty.

<sup>157</sup> Arrianus, Flavi Lucius "Alexandria Anabasis" te "Ilirët dhe Iliria te autorët antikë", Prishtinë, 1979, faqe 234-236; Plutarku: "Alexander", 1.10, faqe 5-7 dhe Justin: "Historiarum Philippicarum", libri XLV, 9, 6-7; Diodor: "Bibliitheke historike" 16, 94-17 dhe Gehrke, Hans-Joachim: "Geschichte der Hellenismus", Munchen, 2003, f. 144.

<sup>158</sup> Arrianus, Flavi Lucius: "Alexandria Anabasis", II, kap.3. pika 7, te "Ilirët dhe Iliria te autorët anti-kë", Prishtinë, 1979, faqe 234-236; Gehrke, Hans-Joachim: "Geschichte der Hellenismus", Munchen, 2003, f. 144 dhe Beloch, Karl Julius: "Griechische Geschichte", 2, bd. 3. 2. f.361.



pushtua-ra nga Persia, prej nga vazhdimisht i vinin kërcënimet pjesës së brendshme.

Kapërcimin në pjesë aziatike me ushtrinë prej 44 mijë vetash, Aleksandri e nisi në pranverën e vitit 334, me ç'rast Helespontin e kapërceu te Sesta, prej nga, te Abidosi, iu drejtua gërmadhve të Ilionit (Trojës). Aty nderoi kujtimin e Akilit dhe u drejtua nëpërmes verilindjes, brigjeve të Propantidës, ku e priste ushtria perse, kryesisht nga njësitë vendore, e ashtuquajtur *satrape* (me lidijas, frigas dhe kapadokas) që i shërbenin Persisë dhe udhëhiqej nga greku Menon.<sup>159</sup>

Luftërat e Aleksandërit të Madh me persët filluan në betejën e Granikës, në vitin 334 para erës sonë, të cilën e fitoi në saje të një strategjie të re ushtarake, ndonëse pati edhe humbje të ndjeshme.

Pas kësaj beteje, Aleksandërit të Madh iu hap udha për Azinë e Vogël. Pas humbjes në Granikë, Persët nuk ishin në gjendje që t'i ndalnin depërtimet e më-tutjeshme ushtarake të maqedonasve. Por, vullnet për luftë nuk po tregonin edhe kundërshtarët e tjerë, të cilëve po u drejtohej. Ndër të parët, që u dorëzua pa luftë ishte satrapi i Lydijës, Sard. Pa luftë, Aleksandri i Madh u fut edhe në qytetet e tjera të Azisë së Vogël, ato të Eolidës dhe Jonijes, ndër të cilët, Efesi, porti më i rëndësishëm i Azisë së Vogël.

Në këto pjesë, Aleksandri i Madh u prit kudo si “shpëtimtar nga pushtimi pers”. Hyrja triumfale e ushtrisë maqedonase u përcoll edhe me vendimet e Aleksandërit të Madh që të rrëzohen satrapët dhe tiranët vendorë që ishin në shër-bim të pushtuesve persë. Në këto pjesë, u vendos pushteti demokratik.<sup>160</sup>

Por, në qytetet Milet dhe Halikarnos, Aleksandri i Madh pati punë me para-rojën e fundit perse në Azi të Vogël, që duhej ta ndalnin disi, ose t'ia vështirë-sonin depërtimin për në Persi në mënyrë që atje t'i jepej përgjigjja e duhur ush-tarake. Në këto qytete të rëndësishme bregdetare ishin përqendruar kontingjente të shumta ushtarake, të cilëve u vinin në ndihmë edhe ato nga deti, ndaj të cilave maqedonasit nuk mund të reagonin, ngaqë nuk kishin flotë detare me vete. Por, Aleksandri i Madh, vendosi që ato t'i rrethojë nga të gjitha anët, duke ua ndër-prerë ndihmat nga jashtë dhe nga deti. Kjo dha fryte. Pas disa muajsh, këto qytete u dorëzuan, me çka, me rënien e tyre përfundoi marrja e bregdetit perëndimor të

---

<sup>159</sup> Më gjerësisht shih: Curtius, Rufus: “*Historiae Alexandri Magni Macedonis*”, 3, 12-17; Droysen, Gustav Johann: “*Geschichte Alexanders des Grossen*”, Munchen, 1954, f. 185; Fox, Robin Lane: “*Alexander der Grosse*”, Stuttgart, 1974, f.229; Fox, Robin Lane: “*Alexander der Grosse*”, Stuttgart, 1974.

<sup>160</sup>Droysen, Gustav Johann: “*Geschichte Alexanders des Grossen*”, Munchen, 1954, f. 185; Curtius, Ru-fus: “*Historiae Alexandri Magni Macedonis*”, 3.

Azisë së Vogël, për t'ia lëshuar rrugën marrjes së brendisë së Azisë së Vogël. Për këtë fushatë, Aleksandri u përcaktua që të jetë në pranverë. U kthye në Gordion, ku i përqendroi trupat për betejat e ardhshme nga Halkisa dhe Kapadokija në drejtim të Persisë.

Përfundimi me sukses i fazës së parë të depërtimit të Aleksandërit të Madh në pjesën perëndimore të bregdetit të Azisë së Vogël, paraqet çlirimin e saj nga pu-shtimi shekullor pers. Çlirimi nënkuptonte edhe organizimin e qeverisjes së poli-seve të Azisë së Vogël. Vendet e çliruara nuk iu bashkuan Maqedonisë, por pjesës së veçantë të perandorisë së tij në këtë pjesë të botës në rritje e sipër. Si formë e organizimit administrativ u ruajt ajo e *satrapive*, si njësi themelore administrative me *satrapët*, në krye të pushtetit civil dhe ushtarak. Për Aleksandërin e Madh e rëndësishme ishte që rregullimi administrativ i këtyre njësive të sigurote mbledhjen e tatimit, të nevojshëm për fushatë. Gjatë çlirimit të këtyre pjesëve, Aleksandri i Madh ua ktheu traditat popujve si dhe dinastitë. Kështu, Lidijanëve ua ktheu ligjet e vjetra. Ndërsa në Karije ktheu në pushtet motrën e Mauzolovit, Aden.<sup>161</sup>

Por, fillimisht Aleksandri i Madh e drejtoi ushtrinë e vet mepërmes Azisë së Vogël, duke marrë Kapadokinë, Frigjinë dhe Nyjet e njohura të Gordionit. Prej andej depërtoi në Kiki dhe mori kryeqytetin Tarsos. Në afërsi të Tarsosit do të jetë edhe beteja e drejtpërdrejtë dhe vendimtare e tij me Darin III të Persisë, ku, në afërsi të Ises do ta mundë. Persët patën shumë humbje, ndërsa Dari III iku duke lënë pas armatën e shkatërruar. Me këtë rast, Aleksandri i Madh zuri rob edhe familjen e Darit (të ëmën, bashkëshorten, Stateiren, të bijat, të birin 5 vjeçar si dhe Baseira, e veja e Memnonit. Me Baseiren Aleksandërit ra në dashuri dhe i lindi i biri, që u quajt Herakli).<sup>162</sup>

Pas kësaj fitoreje, Persët u pajtuan me humbjen dhe kërkuan paqe. Dari i shkroi një letër Aleksandërit të Madh dhe ia përkujtoi lidhjet e dikurshme me të atin dhe "aleancat". Por, Aleksandri i Madh nuk e pranoi. Qëllimi i tij ishte fitorja përfundimtare kundër Persisë në Persi dhe assesi paqja. Nuk vonoi dhe Dari prapë i ofroi paqe Aleksandërit të Madh me disa kushte shumë më të mira. Por, as kjo nuk u pranua. Për Aleksandërin pushtimi i Persisë shfaqej si detyrë e fushatës së tij, si

---

<sup>161</sup> Shih: Kohler, U: "Die Eroberung Asiens durch Alexander den Grossen und der korintischen Bund", Preussische Akademie 1898 dhe Lenschau, Th: "Alexander der Grosse", 1940.

<sup>162</sup> Shih: Arrianus, Flavi Lucius: "Alexandri Anabasis", II, 6-11; Polybi: "Historae", XII 17-22, Diodor: "Bibliotheca Historica", XVII, 32-35.

një ideal jetësor me të cilin ishte rritur e ngritur dhe duhej të marshonte triumfalisht.<sup>163</sup>

Kur pritej që fushata ushtarake e Aleksandërit të Madh të vazhdonte kah Persia, papritmas mori kahun e Sirisë në drejtim të Palestinës. Aleksandri i Madh vendosi që ta lërë për pak anash Persinë, ngaqë e dinte fuqinë e flotës së saj dhe veprimet që mund të prodhonte ajo në disa rrethana. Kështu, në vitin 332 prej andej depërtoi deri te Gaza. Me marrjen e Gazës, Aleksandri i Madh krijoi pikën më të përshtatshme për mbikëqyrjen e rrugëve detare ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit. Në këtë pjesë, Aleksandri i Madh u ndesh edhe me rezistencën e fuqishme të arabëve dhe dy herë mori plagë në luftimet me ta, por ia doli që t'i nënshtrojë.

Ashtu si e kishte paraparë, Aleksandri i Madh marshimin e mëtutjeshëm e vazhdoi në drejtim të Egjiptit, vend ky tepër i rëndësishëm që ndodhej nën pushimin e Persisë, shkëputja e të cilit, persëve ua përgjysmonte fuqinë mbrojtëse. Këtë fakt e dinte Aleksandri i Madh dhe dëshironte që atje të shfaqej si çlirimtar, prej nga pastaj, do t'i kthehej Persisë. Fushata e tij kishte dy drejtime: rrugët tokësore, dhe ato detare. Aleksandri i Madh ia mësyu Egjiptit nëpërmes Helio-polisit. Te tempujt e Memfisit bëri fljijimet për ta. Aty iu dha kurora e Faraonit të Egjiptit të Epërm dhe të poshtëm.<sup>164</sup>

Pasi kaloi në anën perëndimore të Nilit në drejtim të Veriut, në janar të vitit 331 para erës sonë, Aleksandri i Madh, në brigjet e Mesdheut ngriti qytetin Aleksandria, njërin ndër qytetet më të mëdha të antikitetit, një metropol civilizimi, ku edhe u vendos biblioteka më e pasur e botës bashkë me teatrin dhe pjesët e tjera të artit dhe të kulturës. Prej andej, në mars të vitit 331, nga Paraetoniumi, vazhdoi 400 kilometra në pjesën jugperëndimore nëpër shkretëtirë për te orakulli Siwa, tempull i zotit Amun. Disa burime antike bëjnë të ditur se atje, nga priftërinjtë u prit si “bir i zotit Zeus”, fakt ky që e ndërlidh me përkatësinë pellazge-ilire, së cilës, në këtë mënyrë, tregonte se i kishte mbetur besnik. Nga andej, Aleksandri i Madh u kthye në Memfis dhe vazhdoi me trupat e tij për në Palestinë.<sup>165</sup>

---

<sup>163</sup> Jacoby: *“Fragmente der griechischer Historiker”*, II dhe Papazoglu, Fanula: *“Istorija helenizma”*, Beograd, 1970, faqe 98.

<sup>164</sup> Curtius, Rufus: *“Historiae Alexandri Magni Macedonis”*, 3, 12-17 dhe Droysen, Gustav Johann: *“Geschichte Alexanders des Grossen”*, Munchen, 1954, f. 185; Fox, Robin Lane: *“Alexander der Grosse”*, Stuttgart, 1974, f.229.

<sup>165</sup> Wielcken, U: *“Alexanders Zug in die Oase Siwa”*, *“Alexander Zug zum Ammon”* dhe *“Zur Entstehung des hellenistischen Königskultes”* te *“Sitzungsberichten der Preuss. Akademi”*, Berlin 1928, 1930, 1938.

Në maj të vitit 331 Aleksandri i Madh u kthye në Tyros, ku edhe filloi depërtimin e tij të njohur nga Siria për në Eufrat, prej nga mori Babiloninë. Rrugën për në Assyri ia preu paksa ushtria e Darit të Persisë, e cila i kishte ngrehur disa prita, të cilat ai i anashkaloi me mjeshtëri me ç'rast edhe pas tre muajsh arriti në Tigër. Te lumi Gaugamelo, u zhvillua beteja e fundit dhe vendimtare me Darin e Persisë, që e fitoi në saje te një strategjie ushtarake, edhe pse kishte përballë ushtrinë perse tri herë më të madhe në numër. Në këtë betejë pati mundësi ta zinte rob Darin. Por, këtë nuk e bëri. E lejoi të largohej, me një pjesë të oficerëve, të cilët lanë prapa armatën, e cila u shkatërrua përfundimisht.

Beteja e Gaugamelos vendosi edhe fatin e Babilonisë. Babilonasit u dorëzuan pa luftë. Aty u shpall "Mbret i Azisë". Në Babiloni Aleksandri i Madh u fascinua nga bukuria e këtij qyteti. Urdhëroi zbulimin dhe rindërtimin e tij, ndërsa satrapin Mazaeus e emëroi përfaqësues të tij aty dhe drejtues të qytetit.<sup>166</sup>

Pas pesë javësh në Babiloni, Aleksandri i Madh iu drejtua tokave të Persisë. Qyteti Susa u dorëzua pa luftë. Në janar të vitit 330, forcat maqedonase arritën në kryeqytetin pers, Persepolis, me ç'rast e dogjën.<sup>167</sup>

Mbreti Dari edhe më tutje vazhdoi të ikte nga Aleksandri, ndërkohë që qytetet dhe krahinat e tij një nga një u dorëzoheshin maqedonasve. Pasi që riemëronte prefektët dhe drejtuesit e mëparshëm, Aleksandri i Madh nderohej me titujt më të lartë. Ikja e Darit, mori fund në Bakterine, te satrapi Besos, i cili kërkoi që t'ua dorëzojë maqedonasve në këmbim të mbajtjes së disa kalimeve kufitare me Persinë. Kur Aleksandri i Madh nuk iu përgjigj kësaj oferte, Besosi e vrau Darin.

Kufomën e Darit, Aleksandri i Madh e përcolli në Persepolis dhe e varrosi me nderime ushtarake.

Nga Persia, Aleksandri i Madh vazhdoi në drejtim të liqenit Kaspik ku mori krahinën Bakterin dhe Sogdigen, krahina në Afganistan, Uzbekistan dhe Turkmenistan të tanishëm. Duke u ngjitur përgjatë rrjedhës së lumit Tarnak, Aleksandri i Madh, në prill të vitit 329 arriti në qendrën e Afganistanit dhe themeloi qytetin Aleksandria në Hindokush (Çarikari i sotëm). Nëpërmes shkretëtirës, ushtria maqedonase kaloi në Turkmenistan. Pasi mori Marakandën, Aleksandri

---

<sup>166</sup>Arrianus, Flavi Lucius: "Alexandri Anabasis", libri III, Teubner, 1928, faqe 13-15, Diodor: "Bibliotheca Historica", XVIII f. 58-60; Kurcije IV, f. 15-16; Plutarh, Aleks.32-37 dhe Griffith, G. T: "Aleksanders Generalship at Gaugamela", te Journal of Hell. Studies 1947, f. 77.

<sup>167</sup>Shih: Arrianus, Flavi Lucius: "Alexandri Anabasis", lib. III, f.18, 11-12 (sipas Ptolemeut - "Geographia"); Diodor: "Bibliotheca Historica", XVIII, f. 72; Kurcije V, f. 7; Strabon:"Geographica", XV, f.730 dhe Droysen: "Geschichte der Hellenismus", 1877; Berve: "Das Alexanderreich", II.

vazhdoi për te Syrdarja, ku në maj 329 themeloi qytetin “Aleksandria Eshate” (Aleksandria e largët), Çudsandandi i sotëm në Taxhekistan. Në pranverën e vitit 328 Aleksandri i Madh kthehet në Sogdien, ku në Amudarja themeloi një qytet tjetër me emrin Aleksandria. Pas dy vjetësh, Aleksandri i Madh kthehet sërish në Baktrien. Aty, u martua me princeshën Roxana.<sup>168</sup>

Kur mendohej se Aleksandri i Madh, pas disa shqetësimeve që po i vinin nga gjeneralët dhe ushtarakët e tjerë, të pakënaqur me bredhjet e vazhdueshme nëpër Persi dhe rrethinë, do të kthehej për në atdhe, vendosi të marshojë për në Indi, ku mendonte se është “kulmi i botës”. Marshimin për në Indi, Aleksandri i Madh e zgjodhi duke kapërcyer Pakistanin nga ana e Afganistanit dhe prej andej nëpër Hindokush, rrugë kjo tepër e gjatë dhe me rreziqe të mëdha. Duke marshuar nëpër pjesët e largëta të lumenjve dhe duke kaluar nëpër maja thuajse të pakalueshme, ndonëse me humbje të mëdha, megjithatë nuk e ndalën Aleksandrin e Madh për në atë që ai e merrte për Indi. Në fillim të vitit 326, nëpër rrjedhën e lumit Kabul, arriti në provincën Gandahar. Prej andej, maqedonasit depërtuan edhe në pjesën e Penxhabit. Më tutje, u vazhdua në drejtim të Lindjes, për te mbretëria e Magadasë, të cilën, Aleksandri i Madh dëshironte me çdo kusht ta pushtonte. Por, nuk ia doli t’i afrohej ngaqë u pengua nga të reshurat e mëdha si dhe vërshimet, ku një pjesë e ushtrisë vendosi të kthehej, ndonëse shpresat i kishin të vogla. I ballafaquar me rrethanat e rënda, Aleksandri i Madh vendosi të kthehej. Në brigjet e lumit Hyphasis themeloi një tjetër qytet me emrin Aleksandria.<sup>169</sup>

Kthimi i mundimshëm nga Hydaspes zgjati deri në shtator të vitit 325 para erës sonë. Në Bukephala u fillua ndërtimin i rreth 800 anijeve me të cilat do të lundrohej nëpër lumë deri te Oqeani Indian.<sup>170</sup>

Bëhet e ditur se lundrimi me anije nuk shkoi si duhej. Rrjedhës së lumit për në oqean, shumë anije u prishën dhe me to u fundosën një pjesë e mirë e ushtarëve maqedonas. Pjesa tjetër e rrugës nëpër viset e Indisë, ishte po ashtu e mundimshme dhe me humbje, pasi që ushtria maqedonase ngado haste nëpër prita dhe rezistencë. Por, ajo që më së shumti i kushtoi ushtrisë maqedonase gjatë kthimit, ishte kapërcimi nëpër shkretëtirën e Gerdrozisë (Beluqistani i tanishëm), edhe pse deri më atëherë askush nuk ia kishte dalë ta bënte atë rrugë që quhej “rruga e vdekjes”. Edhe pse nuk dihen arsytet e kësaj aventure, mendohet se Aleksandri i Madh zgjo-

<sup>168</sup> Fox, Robin Lane: “*Alexander der Grosse*”, Stuttgart, 1974, f.229.15 dhe Justin: “*Historiarum Philippicarum libri*” XLIV, 10-13.

<sup>169</sup> Bosworth, Brian Albert: “*The Indian campaigns*”, te “*Brill’s Companion to Alexander the Great*”, faqe 159-168; Hahn, Johannes: “*Alexander in Indien*”, Stuttgart, 2000.

<sup>170</sup> Hahn, Johannes: “*Alexander in Indien*”, Stuttgart, 2000.

dhi “rrugën më tëk shkurtër”, që t’i ikë ndonjë “befasie” nga kundërshtarët e mund-shëm, ndër të cilët mbreti Semiramis. Megjithatë, me ushtrinë e tij të përgjysmuar, Aleksandri i Madh, në dhjetor arriti në Puren (Bampurin e sotëm).

Duke u kthyer, në Susa, në janar 324 para e.r., Aleksandri i Madh themeloi edhe një Aleksandri tjetër, Golashkerdin e sotëm. Aty, ndodhi “martesa më e madhe në botë”, kur me urdhrin e tij, 10 mijë gra perse u martuan me ushtarët maqedonas. Aty, në shenjë të miqësisë midis perseve dhe maqedonasve, Aleksandri u martua me dy femra: Starieren, të bijën e Darios dhe Parasysatisen. Martesat u lidhën sipas riteve perse. Pas kësaj, filloi edhe lirimi i pjesshëm i ushtarakëve për në atdhe. Në Ekbatan, më 324, Aleksandri i Madh lejoi mbi 15 mijë ushtarë për t’u kthyer. Disa prej tyre, pasi u martuan me perse, mbetën përherë në ato vise.<sup>171</sup>

Në shkurt të vitit 323 para erës sonë, Aleksandri i Madh u kthye në Babylo-ni. Aty bënte plane për fushëbetejat e ardhshme, ku parashihej pushtimi i Siujdhesës së Arabisë, por edhe ndërmarrja e disa ekspeditave hulumtuese, ndër të cilat shfaqej edhe ajo për Detin Kaspik dhe të ngjashme në Indi dhe Afrikë.<sup>172</sup>

Këto plane mbetën në letër, ngaqë gjatë një ceremonie të mbajtur me rastin përkujtimit të mikut të tij të vdekur Hefastios të shpallur gjysmëzot, pas një pije, iu shfaq një molisje, që të nesërmen iu kthye në ethe të rënda.<sup>173</sup> Ethet embërthyen për shtatë ditë me radhë nga të cilat, vdiq më 10 qershor 323.<sup>174</sup>

Trupi i Aleksandërit të Madh u balsamua me mjaltë. Edhe pse thuhet se e la me fjalë që të varrosej në Ammonium te Siwas, u varros në Aleksandria. Kjo ndodhi pas dy vjetësh. Mbreti Ptolemeu i Parë e dërgoi në Siri dhe prej andej për në Egjipt. Fillimisht eshtrat u vendosën në Memfis dhe vetëm pas vdekjes së Ptolemeut, trupi u dërgua në Aleksandri, në një varr të veçantë për të. Mbreti Ptolemeu IV, ndërtoi një Mauselium të madh ku u vendos në një sarkofag të artë. Në shekullin I, mbreti Ptolemeu X, sarkofagun e zëvendësoi me një të xhamit,

---

<sup>171</sup>Arrianus, Flavi Lucius: “*Alexandri Anabasis*”, libri VII, kap. 4, faqe 4-8.

<sup>172</sup>Shayermeeyer, Fr: “*Die letzten Pläne Alexander der Grossen*”, te *Jahreshete des Österreichische Instituts*“, 41-1954, faqe 118 dhe Wilcken, U: “*Die letzten Pläne Alexanders der Grossen*”, Sitz. Ber. D. Preussen, 1937, nr.24, faqe 192.

<sup>173</sup>Edhe pse nga disa të dhëna thuhet se Aleksandri i Madh mund të jetë helmuar, dhe se kjo çështje do të ngritet nga e ëma, pas gjashtë vitesh, kur edhe do të dënojë disa veta “për helmimin e të birit” (shih: Badian, E: “*Journal of Hellenic Studies*”, 1961, faqe 24 dhe 35), megjithatë, te “*Emeferida*”, që sjell Plutarku, duke u mbështetur nga të dhënat e Arrianus, Flavi Lucius nga vepra e njohur “*Alexandri Anabasis*”, libri III, Aleksandërit vdekja i kishte ardhur nga ethet, të cilave u kishte bërë ballë për një javë. Hulumtuesit e mëvonshëm, vlerësojnë se Aleksandri i Madh u sulmua nga ethet e malaries së Nilit, të shpeshta në ato anë, që iu kishin kthyer në një leukemi akute. (Shih: Benston, H: “*Griechische Geschi-chte*”, faqe 348).

<sup>174</sup>Stoneman, Richard: “*Alexander the Great. A Life in Legend*”, New Haven, 2008, fa.6.

ku shihej trupi i balsamosur i tij. Varri i tij, në antikën e vonshme, nga një katastrofë e natyrës që goditi qytetin, në shekullin IV, humbi.<sup>175</sup>

Vdekja e hershme e Aleksandërit të Madh ishte e pritshme që të përcillet edhe me rënien e ngrehinës më të madhe perandorake botërore, të cilën e ai e ngriti brenda dymbëdhjetë vjetësh, por në historinë e njerëzimit ai zuri vendin e pushtuesit gjenial, në funksion të ndërtimit të botës së re. Vepra e tij madhore, ndonë-se kishte shtratin te ajo që trashëgoi nga i ati, Filipi II si dhe rrethanat nëpër të cilat kaloi mbretëria e Maqedonisë gjatë kohës së ngritjes së saj hegjemone mbi antagonizmat që ushqenin botën pellazge-ilire me atë të Helladës, megjithatë nuk do të ishte e tillë pa vullnetin për fuqi, e mbi të gjitha pa vizionin për të krijuar një perandori botërore të vlerave universale, ku strategjia ushtarake e pushtimit përcillej me konceptin e çlirimit, të lirisë në funksion të ndërtimit të një bote të re.

Kur thuhet kështu, kihet parasysh se Aleksandri i Madh shfaqet ndër ushtarakët më të fuqishëm të botës në histori dhe më të suksesshmit njëherësh. Betejat e tij, nga aspekti ushtarak, mbesin ndër më të njohurat, jo vetëm për fitoret e vazhdueshme, por për strategjinë e përdorur, risitë ushtarake dhe mjetet e luftës, të cilat vazhdimisht i përputheshin me rrethanat qofshin ato edhe ndër më të paparashikueshmet me të cilat do të ndeshet në Persi e deri në Indi. Aleksandri i Madh mbet i vetmi ushtarak që nuk e ka humbur asnjë betejë. Ndaj, edhe epiteti “Aniketos” (i pathyeshëm) nuk ka vetëm kuptim ushtarak, meqë fitoret ushtarake u përcollën me ato shoqërore, ekonomike e mbi të gjitha me ato politikenë shërbim të krijimit të një perandorie botërore mbi konceptin e *monarkisë absolute* me pjesëmarrjen e popujve të ndryshëm të botës, në radhë të parë maqedonas, grekë, aziatikë, paçka se ata u takonin kulturave të ndryshme dhe traditave thuajse të panjohura mes veti.

Modeli i monarkisë absolute, në saje të faktorëve shoqërorë, ekonomikë dhe kulturorë, që u përfshinë në të kuadër të një realiteti imponant politik, me të drejtë i atribuohet filozofisë politike heleniste, për ç’gjë merita të jashtëzakonshme ka vizioni i Aleksandërit të Madh për jetësimin e tyre me mjete ushtarake. Nuk duhet harruar se kjo formë e qeverisjes burimin e vërtetë e ka te modelet monarkike pellazge-ilire të shfaqura me Trojën dardane, me Perandorinë Hitite, Mbretërinë Frigje (Brayge) e deri te ajo e Romës. Ndonëse ato nuk kishin dimensionin hapësinor të Perandorisë së Aleksandërit të Madh e as pjesëmarrjen

---

<sup>175</sup> Heuss, Alfred: “Alexander der Grosse und die politische Ideologie des Altertums”, te “Antike und Abendland” 4, 1954, faqe 94.

asimetrike të qeverisjeve autonome në të çfarë e kishin ato në Persi e deri në Indi, megjithatë, Mbretëria Dardane e Trojës, ajo Hitite, e Frigjëve (Brygëve) e deri te e Romës ishin perandori të mëdha, të përmasave botërore, për aq sa ato njiheshin. Dhe, ç'është më e rëndësishme, ato perandori, përshkoheshin nga ideja e një bote të lirë, me shpirt të lirë, pasqyrimi i së cilës gjeti shprehje në krijimtari, art dhe filozofi me vepra monumentale si pjesë e një qytetërimi monumental, gjurmët e të cilit mbetën në Trojë, Mikenë, Ilirik, dhe kudo në Mesdhe dhe Afrikë. Madje, edhe ndërtimi i dhjetë Aleksandrive (qyteteve) nga Aleksandri i Madh në pjesë të ndryshme të botës, bibliotekave dhe teatrove, ishte vetëm një ripërsëritje e atyre që ai kishte parë në Dodonë, Athinë dhe pjesë të tjera, frymën e të cilave dëshiron ta rikthente dhe ta pavdekësonte nëpërmes veprave madhore të artit dhe të kulturës si fuqi e pandashme e njerëzimit në kuadër të një perandorie të organizuar dhe të ndërtuar mbi sistemin e qëndrueshëm të vlerave, që duhej të mbetej preokupim gjithëkohor dhe gjithënjëzësor.

Por do të shihet se projektet gjithëkohore dhe gjithënjëzore, çfarë ishte ai për të cilin luftoi dhe punoi Aleksandri i Madh, mund t'i përkasin iluzionit, por assesi përjetësisë, ngaqë realitetet politike janë të pamëshirshme, kur atyre u mungojnë bartësit e ideve të tilla të mëdha dhe koncepteve që dalin prej tyre.

Këtij fatumi historik nuk ishte e mundur t'i shpëtojë as vepra e Aleksandërit të Madh. Si do të shihet, vdekja e hershme e tij u dha shkas kryengritjeve të ndryshme, të cilat ia hapën rrugën edhe shpërbërjes së perandorisë së madhe botërore që e kishte ngritur ai gjatë luftimeve për rreth njëzet vjet me radhë.

Dhe, nëse kihet parasysh modeli i perandorisë absolute nga shtrati i atyre pellazge-ilire mbi të cilat u ngrit hegjemonia maqedonase nga Filipi II e deri te Aleksandri i Madh duke rrënuar modelet e poliseve-shtete të qyteteve greke në dekadencë e sipër, që monarkinë “e barbarëve” (Ilirëve) e quante armikun më të madh, ishte e pritshme që këto tronditje kundër kurorës mbretërore të fillonin në Greqi, prej nga Aleksandri i Madh, njëzet e tre vjet më parë, kishte nisur fushatën në drejtim të Lindjes për ta ngritur mbretërinë e tij të madhe. Athina, gjithnjë duke u mbështetur mbi argumentin se monarkitë ishin mendësi politike e barbarëve, ndërsa demokracia e poliseve ishte shkalla më e lartë shoqërore-politike, ishte e para, e cila në vitin 322 para erës sonë, krijoi një lidhje me disa qytete të reja për t'u shkëputur nga mbretëria maqedonase, pra për t'iu kthyer modelit të demokracisë, që me aq zjarr e mbronte Demosteni dhe filozofët tjerë të kohës.



Fillimi i luftërave Lamike, që megjithatë, përfunduan me fitoren e maqedonasve, nuk ishin tjetër pos një përpjekje, që në emër të “demokracisë” dhe kundër monarkisë absolute, ndonëse ajo i kishte dhënë vulën asaj që merrej si helenizëm, për të rikthyer prapa rrotën e historisë.

Por, pas një viti sërish shpërthyen luftimet për trashëgiminë e tij të quajtura si Luftëra të diadohëve (diadohën = trashëgimtarët). Këto lufta (gjashtë sosh) zgjatën për afër tridhjetë vjet dhe në vitin 281 përfunduan me shpërbërjen e mbretërisë së Maqedonisë në tri pjesë: në mbretërinë e Ptolemeut në Egjipt, Mbretërinë Selekuide në Azi dhe në Mbretërinë e Maqedonisë, të drejtuar nga Antigonidët.<sup>176</sup>

Krijimi i tri mbretërive nga Perandoria e Madhe e Aleksandërit të Madh ua hapi rrugën luftërave të ndërsjella midis tyre, në të cilat Athina dhe Sparta, po ashtu, përpiqeshin që të liroheshin nga Mbretëria e mbetur e Maqedonisë. Në vitin 267 para erës sonë u bënë luftërat midis Maqedonisë dhe Athinës e Spartës. Athina e humbi këtë luftë dhe sërish u desh që të pranohet garnizonet maqedonase në qytet.

Edhe në këto rrethana të luftërave me aleatët e saj të deridjeshëm, Maqedonia në kohën e Antigonit II, ia doli të ruajë pozitën dominuese në Gadishull, të ngjashme me atë që kishte në kohën e Fillit II. Por, Antigoni II dhe Antiholosi II në vitet 260-253 para erës sonë, duke shpresuar të rikthenin diçka nga pushteti i tyre i dikurshëm, u përfshinë në luftërat e Sirisë, të cilat zhvilloheshin midis mbretërisë së Selekuideve dhe Egjiptit. Maqedonia që përfshirë edhe në luftën e tretë të Sirisë, në vitin 246 para e. s. në kohën kur Ptolemeu III pushtoi qytetet bregdetare të Trakisë. Egjipti do të përpiqet që Mbretërinë e Maqedonisë ta dobësojë me ndihmën që u jepte Spartës dhe Athinës në luftimet e tyre të herëpashershme me ta. Në vitin 228 para e.s. janë të njohura luftërat midis Maqedonisë dhe Spartës të ndihmuara nga Ptolemeu. Në këto luftime të përgjakshme Maqedonasit mundën Spartën. Me këtë rast, në vitin 217, Filipi V lidhi paqe me Atiolet.<sup>177</sup>

## RIKTHIMI I LUFTËRAVE ME DARDANËT DHE FILLIMI I LUFTËRAVE ME ROMAKËT

---

<sup>176</sup> Shih: Arrianus, Flavi Lucius: “*Alexandri Anabasis*”, libri VI dhe Justin: “*Historiarum Philippicarum libri*” XLIV, 10-13.

<sup>177</sup> Fox, Robin Lane: “*Alexander der Grosse*”, Stuttgart, 1974, f.229.

Krahas luftërave të shumta me aleatët e deridjeshëm (Athinën, Spartën dhe qytetet e tjera greke, që luftonin për rikthimin e fuqisë së tyre duke shfrytëzuar përçarjet e brendshme që e përcillnin perandorinë e dikurshme të Aleksandërit në shpërbërje e sipër), si dhe atyre në hapësirën e Sirisë, Maqedonasit u përfshinë edhe në luftëra të vazhdueshme me Ilirët dhe veçmas me Dardanët, me të cilët kishin një rivalitet të hershëm, të përcjellë me luftëra hegjemone të Maqedonisë nga shekulli V e kënde, të cilat do të vazhdojnë edhe pasi që në Ilirik të shfaqet faktori Romë, që si dihet, pas luftërave që zgjatën për më shumë se një shekull, do t'ua përcaktojë disfatën historike mbretërive maqedonase, dardane dhe atyre ilire.

Në këtë zhvillim luftërat e Dardanëve kundër Maqedonisë, ku u vra sundimtari i saj Demetri II, do të rikthehen me një intensitet të shtuar, edhe për faktin se pas sukseseve të ndjeshme ushtarake kundër Maqedonëve dhe disa fiseve ilire përreth, në rrethanat kur shihej se nuk do të kishte më Maqedoni hegjemone, Dardanët shfaqin haptas pretendimet për të zënë vendin e saj, gjë që çështjet i kthente te rivaliteti historik midis këtyre dy mbretërive, kur edhe gjatë kohës së Filipit II kishte arritur kulmin.<sup>178</sup>

Edhe pse me shfaqjen e Romakëve në brigjet e Jonit dhe të Adriatikut, kishin ndryshuar rrethanat, që do të thotë se pritej ballafaqimi me ta çfarëdo lufte e brendshme do t'u shkonte për shtati atyre, Dardanët edhe më tutje fuqizimin e tyre për t'i kthyer pozitat e dikurshme e shihnin duke i mundur Maqedonasit dhe pastaj polisitet greke në mënyrë që të shkohet kah Azia e Vogël. Dardanët bënin hesap që këto t'i sendërtonin edhe me ndihmën e faktorëve përreth, sidomos me Ilirët përreth, që po ashtu kishin shumë hesape të hapura me Maqedonasit.<sup>179</sup>

Por, shpejt do të kuptohet se Dardanët nuk i kishin për vete Ilirët, siç mendonin. Në kohën e sundimit të Antigoni Dozonit, në saje të një marrëveshjeje që Maqedonasit lidhën me shtetin ilir, Dardanët u nxorën nga pjesët e Maqedonisë dhe të Pajonisë. Ishte fjala për një hesap tjetër ilir asokohe, që kishte të bënte me ruajtjen e baraspeshës Dardani-Maqedoni në përmasat që asaj do t'i krijonin favore. Në qyte-

---

<sup>178</sup> Droysen, J.G: “*Das Dardanische Fürstentum*“, Leipzig, 1893, faqe 27-35.

<sup>179</sup> Rreth luftërave iliro-romake shih: Tit Livi “*Ab urbe condita*” (Nga themelimi i qytetit). Livi është historiani më i rëndësishëm romak i kohës së Augustit. Ai lindi në Patavium (Padovë) në vitin 59 ose 69 para e.r. dhe vdiq në vitin 17 të erës sonë. Ndryshe nga shumë paraardhës të tij nuk mori pjesë në jetën politike. Gjithë jetën e tij mbeti retor dhe letrar. Shkroi një histori të Romës të cilën e titulloi “*Ab urbe condita*” (Nga themelimi i qytetit). Gjithë vepra e tij përbëhej nga 142 libra. Vepra e Livit ka rëndësi të madhe se në të ruhen disa të dhëna mbi fushatën e Aleksandër Molosit dhe Pirros në Itali dhe për luftërat iliro-romake. Për këto të fundit ai plotëson në shumë drejtime ato që mungojnë ose që kanë humbur nga Polibi.

tin pajon, Bylazor, në luginën e lumit Aksios, Maqedonasit vendosën një garnizon të fortë ushtarak, që kështu t'u mbyllej rruga Dardanëve për në Maqedoni.<sup>180</sup>

Luftërat Maqedonase-dardane vazhduan me të njëjtën ashpërsi edhe në kohën e mbretit Filipi V. Shkas për to gjithsesi paraqitej Pajonia dhe mbajtja e saj e pushtuar nga Maqedonasit, që për Dardanët ishte e papranueshme, meqë aty viheshin në sprovë të drejtpërdrejt ambiciet e të dy palëve për pushtet të mëtutjeshëm mbi fiset ilire, por edhe mbi poliset helene, prej nga mund të sigurohej dominimi në pjesën Qendrore dhe atë Jugore të rajonit, me çka mund të pengohej çfarëdo rrezikimi i tyre nga Roma, dhe njëherësh të krijoheshin parakushtet për të shkuar më tutje në drejtim të Lindjes, pra Azisë së Vogël.

Me këto pretendime, në vitin 219, kur Filipi V ndodhej në Peloponez, Dardanët u futën në Pajoni dhe çliruan pjesët që ushtria maqedonase i mbante të pushtuara. Tit Livi njofton se si “atje, pra në Peloponez, Filipi V takoi lajmëtarë që sollën të reja edhe më shqetësuese; mësoi se Dardanët të përhapur në Maqedoni, ishin bërë zotë të Oristidës, se ata kishin zbritur në fushat e Argesit dhe midis barbarëve qarkullonin zëra se Filipi qe vvarë.”<sup>181</sup>

Filipi V, i vetëdijshëm se çfarë do të thoshte prania e Dardanëve në këtë pjesë, sërish sulmoi Bylazorin dhe ia doli që prej andej të largojë Dardanët. Madje, me këtë rast ai pushtoi edhe qytetin Sintia në pjesën jugperëndimore të Dardanisë, dhe në veri të Pelagonisë. Kjo gjendje megjithatë, nuk vazhdoi shumë. Dardanët, duke shfrytëzuar një konflikt të Filipit V me Ilirinë e Jugut, pasi që të kenë lidhur aleancë me sundimtarin e saj, Eropin, në vitin 208 para e.s. sulmuan Maqedoninë dhe ia dolën që me ushtritë e tyre të zbresin deri në Orestidë, një krahinë në kufirin jugperëndimor të Maqedonisë.<sup>182</sup>

Fushata e suksesshme e Dardanëve në Maqedoni bënë që Filipi V përfundimisht dhe me gjithë fuqinë që kishte t'i kthehej Dardanisë, në mënyrë që të hiqte pengesën kryesore në përpjekjet që të përqendrohej në luftërat kundër Romakëve, në të cilat tashmë ishte përfshirë në disa pjesë kahu i tyre duhej të vendoste për fuqinë e ardhshme më të madhe të kohës, edhe pse gjasat për Maqedonasit të kthenin famën e dikurshme ishin gjithnjë e më të vogla ndërkohë që ato të Romakëve për t'u hedhur në pjesën tjetër të Adriatikut, sa vinin e shtoheshin, meqë nga aty mund të zgjeroheshin dhe të forcoheshin për pushtime të mëtutjeshëm. Kjo luftë filloi në vitin 208 para e.s. dhe zgjati për dy vite.

<sup>180</sup> Livi: “*Ab urbe codito*”, libri XXXI/28.

<sup>181</sup> Po aty.

<sup>182</sup> “*Historia e popullit shqiptar*”, vëllimi i parë, Tiranë, 2002, faqe 147.

Lufta e gjatë kundër Maqedonasve në njërin anë dhe ajo e Romakëve kundër Maqedonasve në tjetrën anë, të cilat duhej të përcaktonin faktorin e ri të forcës që tejkalonte përmasat e ngushta, bëri që Dardanët në veçanti dhe Ilirët tashmë të përfshirë në luftërat me Romakët, në përgjithësi të futen në aleanca të herëpashershme të paqëndrueshme me kundërshtarët e tyre, prej të cilave do të kenë më shumë dëme se përfitime. Njëra ndër këto aleanca, në formën e “koalicionit antimaqedonas”, që u shfaq në kohën e luftës së parë maqedonase-romake, ishte ajo midis Ilirëve, Epirotëve dhe Dardanëve, në kohën kur dukeshin shenjat se fitorja e romakëve ndaj Maqedonasve do të mund të kthehej në një përfitim trepalësh për faktin që kjo luftë nuk kishte për qëllim hapësirën e mbretërisë maqedonase, por të kolonive helene në pjesën e Adriatikut dhe atë të Egjeut, ku Athina dhe Peloponezi mbanin monopolin tregtar e me këtë edhe ekonomik në këto pjesë për të cilat Ilirët pretendonin se mbikëqyrja duhej t’u kalonte atyre meqë ishin pjesë e pandashme e Ilirisë. Koalicioni antimaqedonas ishte i gjerë dhe përfshinte që të gjithë kundërshtarët e Filipit V. Por, siç u pa, nuk ishte gjithëaq i përgatitur ushtarakisht për ndonjë përfitim. Përkundrazi, Maqedonasit, pasi që bënë një marrëveshje paqeje me Romakët e zënë me luftërat me Hanibalin dhe, po ashtu, në Lindje, lidhen një aleancë me Atalin III të Sirisë me ç’rast ia dolën që t’i zgjerojnë pushtimet në Egje duke u shtrirë në Helisponde dhe ua mori tokat Etolëve, iu vërsulën Dardanëve si dhe disa pjesëve të Ilirisë.

Por, pasi që në vitin 201 romakët përfundimisht mundën Hanibalin dhedetyruan Kartagjenën të përqafoje paqen e diktuar prej saj, nisi ora e ligë për Filipin V të Maqedonisë dhe mbretërinë maqedonase në përgjithësi. Sepse, pas pak, Romakët do të fillojnë fushatën vendimtare kundër Maqedonisë nga tokat ilire. Në vjesh-tën e vitit 200 legjionet e para romake zbritën në Apolloni dhe ngritën tendat pranë lumit Aps. Prej aty filluan sulmet kundër pozitave të Filipit në Dasareti. Me këtë rast shënohet edhe një “besëlidhje” tjetër ilire kundër Maqedonisë, e lidhur nga Pleurati i Ilirisë, Bato i Dardanisë dhe Aleksandri i Athamanisë.<sup>183</sup>

Krahas këtyre marrëveshjeve të ndërsjella midis Ilirëve dhe Dardanëve kundër Maqedonasve, midis viteve 200 dhe 197, kemi edhe marrëveshje të Dardanëve me Romën midis viteve 200 dhe 197. Në njërin prej tyre, pasi që Romakët

---

<sup>183</sup> Livii: “*Ab urbe condita*”, libri XXXI/28. (*Si mori fund lufta me këtë ekspeditë mjaft të lumtur, shumë mbretër të vegjël dhe prijës fqinjë të Maqedonasve erdhën tek lëmi i Romakëve; Pleurati, biri i Skerdilaidit, e Amyrandri, mbreti i Athamanëve, dhe prej Dardanëve Batoja, i biri i Longarit. Longari kishte luftuar kundër Demetrit, babait të Filipit. Premtimeve të tyre për ndihmë konsulli iu përgjigj se do të shfrytëzonte ndihmën e Dardanëve dhe të Pleuratit, kur do të fuste ushtrinë në Maqedoni; Amunandrit i caktoi të nxiste Etolët për luftë”).*

të kenë korrur suksese të ndjeshme gjatë fushatës së tyre në Dasareti, mbreti i Dardanëve, Batoja, bir i Longarit, Romakëve u ofroi ndihmë ushtarake kundër Maqedonasëve, me kusht që prej saj të përfitonin diçka, duke u zgjeruar në jug.

Si do të shihet, nga këto luftëra do të kenë përfitime vetëm Romakët, ndërsa Dardanët do të mbesin aty ku ishin, pra pa përfitime, pos në armiqësi të mëtutjeshme me Maqedonasit, të cilët edhe në rrethanat e humbjeve me Romakët, do t'ia dalin që të mbledhin forcat për t'i luftuar ata, siç do të ndodhë në të vërtetë në vitin 199 para erës sonë, kur ushtritë dardane, që po tërhiqeshin nëpër Maqedoni, u sulmuan nga forcat e Filipit V. Ndonëse nuk pësuan ndonjë humbje të madhe, megjithatë u pa se nuk do të kishin ndonjë dobi nga aleancat siç ishin ato me Romakët, të cilët, ishin të interesuar që uvertyrën e pushtimeve në lindje, që do të pasojnë pas pak, ta shfrytëzojnë për të përçarë e për të përdorur njëherësh Ilirët dhe Dardanët kundër Maqedonasve dhe anasjelltas në mënyrë që kundërshtarët t'i ketë sa më të dobët dhe sa më të paktë, ndërsa mundësitë për përfitime nga dobësimi i tyre sa më të mëdha.

Kështu edhe do të ndodhë. Në vitin 197 para erës sonë, pas betejës së Kinokefalit, që do të përfundojë në dobi të Romakëve, u vendos një armëpushim midis Romës dhe Maqedonisë. Dardanët megjithëqë luftuan përkrah Romakëve, nuk patën ndonjë përfitim. Përkundrazi, nga kjo paqe maqedonasit përfituan, sepse atë e shfrytëzuan për një fushatë të ashpër kundër Dardanëve. Filipi i V, me forca të shumta, sulmoi Dardanët dhe në betejën e Stobit në Pajoni i theu ata, por pa ia dalë që t'i shkatërrojë plotësisht.<sup>184</sup>

Ka shumë gjasa që për këtë fushatë do të kenë qenë të interesuar edhe Romakët, të cilët dëshironin t'i kishin dy kundërshtarë të dobët në vend të një të fortë, siç mund të ishte rasti me Dardanët, të cilët nga një pikëpamje strategjike për Romën shfaqeshin më të rrezikshëm, jo vetëm pse mbanin pjesën qendrore të Gadishullit Ilirik, prej nga mund të shkohej në Lindje, por edhe pse ishin të një familjeje me Ilirët dhe kurdo mund të bashkoheshin me ta kundër tyre paçka se të shumtën luftonin kundër njëri-tjetrit.

Maqedonasit, të vetëdijshëm se kanë të bëjnë me një armik tepër të qëndrueshëm, i cili nuk mposhtej dot, ndërkohë që tashmë ata ishin përfshirë në luftërat me Romakët, të cilat gjithsesi se për epilog duhej të kishin nxjerrjen e një fitimtari të ardhshëm të përmasave perandorake, bënë çmos që mbretëria e Dardanisë të mos kthehej në faktor kyç që do të vendoste këtë fat.

---

<sup>184</sup> Po aty.

Por, Filipi V, që t'i thyente përfundimisht Dardanët si forcë e rëndësishme, ose, së paku, që t'i mbante në një gjendjeje të trysnisë së vazhdueshme, vendosi që këtë ta bënte me anën e Bastamëve, një fisi që banonte në krahinat e Danubit, të cilët duhej të vendoseshin në tokat dardane. Këtë më së miri e përshkruan TitLivi kur thotë se “qëllimi i Filipit ishte që të zhdukte fisin e Dardanëve dhe të vendoste në tokat e tyre Bastamët. Ai (Filipi) mendonte se prej kësaj do të kishte një përfitim të dyfishtë, nga njëra anë, do të zhdukej fisi i Dardanëve, i cili gjithmonë kishte qenë armik i rrezikshëm i Maqedonisë dhe shqetësonte mbretërit e saj në çaste të vështira, kurse, nga ana tjetër, do të dërgonte Bastamët në Itali që ta shkretinin atë pasi të linin në Dardani gratë dhe fëmijët e tyre”.<sup>185</sup>

Sipas burimeve antike, Bastamët do të vendosen në një pjesë të tokave dardane, por do të jetë vdekja e Filipit V që do t'i hedhë në ujë planet e tij për shthurjen ose dëbimin e Dardanëve nga tokat e tyre duke vendosur Bastamët. Perseu, i cili do ta marrë fronin e Maqedonisë, megjithatë do të përpiqet të ndezë një luftë midis Bastamëve dhe Dardanëve, së paku që t'i dobësojë ata, meqë ishte i vetëdijshëm se në mos Dardanët, atëherë Romakët do të ishin ata që do të merreshin me Bastamët, të cilët madje, nga ana e tyre, edhe mund të përdoreshin kundër Maqedonasve.

Sipas Tit Livit, bashkë me Bastamët në tokat dardane ishin vendosur edhe forca trakase dhe Skordikët, të cilët pas vdekjes së Filipit V do të tërhiqen, ndërkohë që Bastamët edhe më tutje shpresonin se mund të mbeteshin në tokën e premtuar ku ndjeheshin mirë. Kështu, në dimrin e vitit 176-175 Dardanët sulmuan ngulimet Bastame në Dardani dhe pas një lufte, që ishte me kthesa (meqë njëra pjesë e ushtrisë dardane thuajse ishte mundur), ia dolën që me pjesën tjetër të ushtrisë së tyre të detyrojnë Bastamët të largohen nga Dardania.<sup>186</sup>

Dëbimi i Bastamëve, Dardanëve nuk ua hoqi kërcënimin saqedonas, me të cilin tashmë ishin mësuar. Perseu, në vitin 172, mori përsipër një fushatë tjetër të gjerë kundër Dardanëve, me një ushtri prej njëzetmijë vetash, një pjesë e të cilëve ishte nga radhët e falangës së njohur maqedonase, që u udhëhoq prej tij. Perseu shënoi fitore në këtë luftë, por nuk ia doli të gjunjëzojë përfundimisht mbretërinë dardane.

Ndodhi, megjithatë, që në këtë kohë, Mbretëria Dardane sërish të marrë veten në saje të dy veprimeve të rëndësishme. I pari kishte të bënte me forcimin e miqësisë, qoftë edhe të përkohshme, me Ilirët (martesa e Teutës, të bijës së mbretit Monun, me Gencin), e cila u shoqërua me një aleancë, po ashtu të përkohshme

<sup>185</sup> Tit Livi: "Ab urbe condita", libri XLI/19.

<sup>186</sup> Po aty, Libri XLI/19.

për veprime të përbashkëta ushtarake kundër Maqedonisë. Veprimi i dytë kishte të bënte me lidhjen e një aleance tjetër me Romakët, pasi që Genci, do të shkëpusë lidhjet që mbante me Romën për t'i rikthyer ato me Maqedonasit, me çka përfundimisht u largua prej tyre dhe u afrua me këta të fundit. Dardanët, për t'u mbrojtur nga kërcënimi maqedonas, i cili i rrezikonte më shumë se kurrë, vendosën që të kërkonin ndihmë nga Romakët, me anën e një lidhjeje të re.

Lidhja e dytë dhe e fundit e Dardanëve me Romakët dhe ajo e Mbretërisë Ilire të Gencit me Maqedonasit, pasi që të ketë shkëputur lidhjen thuajse vasale me Romën, do të shënojë fillimin e fundit të Maqedonasve dhe njëherësh edhe të Mbretërisë së Gencit.

Edhe në këto rrethana pra të aleancave të zhdrejta në njërën anë të dardanëve me romakët dhe në tjetrën anë të asaj ilire me Maqedonasit (mbretit Genc me mbretin Perse), Roma kërkonte që të ndante disi Gencin nga Perseu, në mënyrë që të mos kishte për kundërshtarë dy mbretëri, të cilat mund t'i nxirrnin telashe. Kësaj nuk ia doli, ngaqë Ilirët vlerëson se fitorja e Romës kundër Hanibalit, nuk e kishte forcuar pozitën e saj në rajon. Përkundrazi, në Lindje dhe Azi kishte disponim të mjaftueshëm që Romakëve t'u prehej rruga në Ilirik, në luftë kundër Ilirëve dhe Maqedonasve, të cilëve do t'u vihej në ndihmë nga atje. Kjo bërë që në nëntor të vitit 172 para e.s., senati romak të urdhërojë dërgimin e forcave të para në Iliri. Një numër sosh u dërgua edhe në Greqi. Pasi që ishte pozicionuar si duhej në Thesali, në pranverën e vitit 171, Roma vendosi të fillonte luftën përfundimtare kundër Perseut, meqë ai ishte i rëndësishëm nga pikëpamja strategjike.

Kjo luftë, që zgjati mbi pesë vjet, ofroi edhe më shumë Gencin dhe Perseun e Maqedonisë. Në janar të vitit 168 ata lidhën edhe një aleancë antiromake. Por, fundi i Maqedonisë ndodhi gjatë luftës së tretë kundër Romës në vitin 168 kur Perseu tentoi që të kthejë fuqinë e dikurshme të Maqedonisë.

Ç'është e vërteta, aleanca antiromake, e fundit për ta, ishte fatale edhe për Gencin dhe mbretërinë ilire, meqë mbretëria ilire hyri në luftë kundër Romës. Kjo i dha shkas Romës që me një fushatë të fuqishme të sulmojë Ilirët dhe të nënshtrojë drejtpërdrejt provincën jugore ilire dhe me të të asgjësojë mbretërinë ilire. Prijësi ushtarak romak, Luc Anici Gali, në krye të 30 mijë ushtarëve, u nis në drejtim të Shkodrës së fortifikuar, kryeqytet i shtetit ilir, ku ishte strehuar mbreti.<sup>187</sup>

---

<sup>187</sup>Stipçeviq, Aleksandër: "Ilirët", Prishtinë, 1980, faqe 60.

Humbja e luftës kundër Romës, këtë herë ishte ndryshe nga ato që ishin pësuar gjatë kohës së Teutës ose më vonë, kur humbësit, me anën e marrëveshjeve të paqes, u nënshtroheshin kushteve të Romës, e cila, rëndom kënaqej me tribute të rënda, siç ishte rasti me Teutën, ose me vasalitetet me Pleuratin dhe Demeter Farin. Roma tash kishte vendosur t'i jepte fund Mbretërisë Ilire, asaj Maqedonase dhe krijesave të tjera të ngjashme përtej detit, që të vendoste përfundimisht hegjemoninë e vet në rajon dhe pjesët tjera kah Lindja. Kështu, pas mbarimit të luftës, Roma u mor me ndarjen administrative të tokave të mbretërive të mundura. Kësaj mase i parapriu vendimi i Senatit Romak që të shpallë "të lirë" Ilirët dhe Maqedonasit.

Në Shkodër, në vitin 167 para e.s., komandanti i ushtrisë romake, Luc Anici, në praninë e pesë të dërguarve të posaçëm të Romës dhe përfaqësuesve të parë ilirë proromakë, bëri të ditur vendimin e Senatit Romak, me ç'rast tokat ilire u ndanë në tri njësi administrative të veçanta.<sup>188</sup>

Në krahinën e parë, me qendër Lisin, qenë përfshirë tokat rreth qytetit deri te lumi Mat. Njësia e dytë administrative përbëhej nga krahina e banuar prej La-beatëve, qendra e së cilës ishte Shkodra. Ndërsa, në krahinën e tretë bënë pjesë viset bregdetare ilire në veri të Shkodrës dhe të lumit Naronë, duke përfshirë qytetin Rizon dhe Olcin (Ulqinin).<sup>189</sup>

Ngjashëm u veprua edhe në Maqedoni, me rastin kur ajo u shpall provincë e Romës, nën mbikëqyrjen e Senatit.

Ç'është e vërteta, vite më vonë, më 149-148, atje, nën drejtimin e Andronikut pati edhe një kryengritje maqedonase kundër pushtuesve romakë, që solli te lufta e katërt, por me vrasjen e Andronikut, në vitin 146, mbretëria e Maqedonisë pushoi se ekzistuar.

Në fundin historik të Mbretërisë së Maqedonisë mund të thuhet se pati pak gisht edhe Mbretëria e Dardanisë, e cila, për të ruajtur fuqinë e vet në këtë pjesë, pati një aleancë me Romën. Por, si do të shihet, rënia e mbretërisë maqedonase nuk ua forcoi pozita as Dardanëve e as Ilirëve. Përkundrazi, triumfi romak në Maqedoni njëherësh paraqiti edhe fundin e lidhjeve të Dardanëve me Romakët.

---

<sup>188</sup> Po aty.

<sup>189</sup> Po aty.





## KAPITULLI I DYTË

### ILIRIKU DHE ROMA

#### PUSHTIMET ROMAKE DHE KRYENGRITJET ILIRE

Rrënimi i Mbretërisë Ilire të Gencit dhe përfshirja e viseve ilire nën administratën e re perandorake sipas modelit të autonomive (*civitate*) nuk përmbyllte procesin e pushtimeve romake të parapara sipas skenarit për nënshtrimin e plotë të Ilirisë, të Maqedonisë dhe të Greqisë nën sundimin e saj. Me rrënimin e Mbretërisë Ilire të Gencit dhe të Mbretërisë Maqedonase, me siguri se ishte arritur shumëçka e asaj me çka do të duhej të përmbylej triumfi romak përtej detit, por jo edhe fitorja përfundimtare e tyre. Sepse, kishin mbetur Mbretëria Dardane dhe Federata e Dalmatëve, të cilat shfaqeshin të pavarura dhe me një fuqi të theksuar, që do t'i kthehen në një pengesë të madhe Romës.

Natyrisht se në këtë strategji të Romës, Dardanët për shumë arsye kishin një vend të veçantë, që gjithsesi ato të natyrës strategjike meritojnë të përmenden nga që me anën e tyre sërish del në pah rëndësia shumë e madhe e Dardanëve dhe e Dardanisë si fuqi e kahershme, nga Troja e këndeje, që lidh Europën Qendrore me Azinë e Vogël, siç del edhe mundësia e marrjes përsipër prej saj të një fronti të rezistencës së gjerë antiromak, ku do të përfshihej faktori epirot dhe maqedon etnikisht të lidhur me të. Këta të fundit, në rrethanat e reja mund të gjendeshin në të njëjtën anë.

Të vetëdijshëm për këto çështje, Romakët morën të gjitha masat që fillimisht Dardanët dhe Dardaninë t'i mbajnë të shkëputur nga pjesa epirote dhe ajo maqedonase në jug dhe lindje, duke ua krijuar rrethin romak, siç do të bëjnë çmos që ata të shkëputen edhe nga çfarëdo lidhjeje me pjesët e tjera të mbetjes ilire jashtë pushtimit në pjesën perëndimore (Dalmatëve, Ardijanëve, Plerejve dhe të tjerëve), që si të shkëputur, t'u nënshtrohen rrethanave të reja, pra të pranohet roli i vasalit "të privilegjuar", siç u kishte ndodhur Labeatëve, Japodëve, Doarsëve dhe disa të tjerëve, në vend se të pushtohen me anën e luftës.

Strategjia e mbajtjes së Dardanëve të shkëputur për një kohë të gjatë sigurisht se do të ishte e padobishme dhe e dëmshme madje, po qe se atyre nuk do t'u

merrej mundësia që të kishin aleatë, ose bashkëveprues për frontin e mundshëm antiromak. Andaj, ishte fare e natyrshme që Romakët të vazhdonin më tutje qërimin e hesapeve në Veri të Ilirisë me “mbetjet” ilire: Dalmatët, por edhe Ardiejt, Plerejt, Japodët dhe fise të tjera të ndërlidhura mes veti ose të shkëputura, në mënyrë që pjesa në perëndim të Dardanisë të kthehej në hapësirë “të pastër” romake.

Ç’është e vërteta Dalmatët në Ilirinë e Veriut shfaqen si fuqi e rëndësishme politike në shekullin II para erës sonë. Tokat e tyre ndodheshin në krahinën e brendshme në jug të Alpeve Dinarike, ku gjendej edhe qendra e tyre në kështjellën Delminion.<sup>190</sup> Këtu ata krijuan një federatë të fuqishme, që erdhi e u shtri në drejtim të bregdetit Adriatik, ku tokat e saj arritën deri te lumi Tilor, në fqinjësi me Liburnët. Në jug shtriheshin nga lumi Tilor (Cetina) dhe te rrjedha e poshtme e Naronës (Neretvës), e deri te brigjet jugore, ku banonin Doarsët.<sup>191</sup> Në lindje, pushteti i Dalmatëve, arrinte deri te viset e Desidiatëve në Bosnje. Burimet antike bëjnë të ditur se Dalmatët shfaqeshin edhe si fuqi bregdetare, që pos skeles Salona, kishin edhe qytete të tjera.<sup>192</sup>

Federata e Dalmatëve, gjatë kohës së Pleuratit, një kohë ishte në varësi të shtetit Ilir. Pas ardhjes së Gencit në krye të shtetit ilir, më 181 para erës sonë, ata prapë u bënë të pavarur. Kohën nga shkëputja prej Gencit e deri te rënia e tij përfundimtare në vitin 168 para e.s., pra kur do të kenë një hapësirë veprimi, Dalmatët e shfrytëzuan që të forcohen edhe më tutje, gjë që shkonte në dëm të interesave të Romës, e cila edhe vasalët e planifikuar, e edhe “mbretërit e pavarur”, dëshironte t’i kishte sa më të parrezikshëm dhe të varur. Kështu, pas pushtimit të shtetit ilir, Dalmatët dhe federata e tyre u gjenden në shënjestër të Romës, meqë planet romake për pushtimin e pjesës veriore kalonin doemos nëpërmes tokave ilire nga Adriatiku, Dalmacia e deri në Danub (Panoni) e deri te Alpet.

Si me rastin e Teutës dhe më vonë të Gencit, Roma filloi edhe këtu të kërkonte shkaset për luftë tek sjelljet e Dalmatëve ndaj banorëve të Isës, që ankoreshin se ua cenonin vendin si dhe qytetet Epetin dhe Tragyrin. Madje, flitej edhe për ankesat e ngjashme të Daorsëve, për ç’arsye do të denoncohen nga Gai Fani, i cili para Senatit raportoi se Dalmatët jo vetëm që nuk donin të ndreqnin gabimet kundrejt atyre që ankoheshin e vazhdimisht pësonin prej tyre, por as që donin ta dëgjonin atë, duke thënë se s’kishin të bënë fare me Romën.<sup>193</sup>

---

<sup>190</sup> Po aty, faqe 154.

<sup>191</sup> Po aty, faqe 154.

<sup>192</sup> Straboni: “*Geographica*” (Gjeografia), Libri VII/3, 4, 7,8.

<sup>193</sup> Polibi: “*Historiae*” (Historitë), Libri XXXII/9

Se çfarë fshihej prapa “ankesave” të të deleguarit të Romës para Senatit, këtë na e sqaron fare miri Polibi kur thotë: “duke ndërmarrë një fushatë kundër Dalmatëve, në njërën anë do të nxitnin dhe do të ngritnin shpirtin luftarak të popullit të tyre dhe, në anën tjetër, do t’u jepnin një mësim Ilirëve dhe do t’i detyronin t’i nënshtroheshin sundimit të Romës. Për këtë arsye Romakët u shpallën luftë Dalmatëve, por përpara popujve të tjetër hiqeshin se e bënë këtë për shkak të sjelljes së keqe të Dalmatëve ndaj përfaqësuesve të tyre”.<sup>194</sup>

Kështu, Roma i mbetej besnike rrugës së filluar me Teutën, kur duhej krijuar shkase, në mënyrë që qërimi i hesapeve të dukej i kufizuar, pra si mbrojtje e interesave vetanake, me çka synohej që faktorët e tjerë ilirë, të mbeteshin anash.

Me strategjinë e luftës hap pas hapi me Ilirët, Romakët iu sulën edhe Dalmatëve. Siç pritej, “shkasi”, u kërkua te fushatat e vazhdueshme të tyre, që legjioneve romake t’u priten rrugët e depërtimit për në pjesën qendrore dhe atë lindore. Pas dy-tri “notave” të përcjella me disa debate në senatin romak, në vitin 156 para erës sonë, filloi fushata ushtarake kundër Dalmatëve, ndonëse ajo nuk shkoi sipas parashikimeve as në fillim e as më vonë. Bëhet e ditur se konsulli romak, Gaj Mark Figuli, gjatë asaj përpjekjeje, nuk ia doli që të futej në viset dalmate. Madje, gjatë ballafaqimit të parë me ta, pati humbje të mëdha që e detyruan të kthehej prej nga ishte nisur. Por, kjo nuk i ndali Romakët, të cilët e dinin se nuk mund të shkonin tutje pa i hequr qafesh dalmatët e fuqishëm. Kështu, ushtria romake do të kthehet, por me një konsull tjetër më të përgatitur. Ishte Kornel Scipio Nazika, i cili sulmoi nga shumë drejtime. Pas shumë betejave të përgjakshme dhe humbjeve të mëdha, Nazika ia doli të depërtojë në Delminium, të cilën do ta shkatërrojë, por jo edhe “ta paqësojnë” gjithë vendin siç ishte paraparë, meqë mbetën pjesë të pavarura, ku Romakët nuk ia dolën të hyjnë.

Kjo nuk e pengoi Kornel Nazikën të shkojnë më tutje. Taborët e shumta romake, në rrugën e tyre drejt qendrës dhe lindjes, nuk duhej të ndalonin më pa marrë parasysh humbjet. Kështu që pas Dalmatëve, të cilëve do t’u shkatërrohen qytetet kryesore dhe hapësira më e madhe jetësore, Romakët, me radhë, sulmuan edhe vendet veriore ilire, ato të Japodëve dhe Panonëve.

Krahas vendeve veriore, në gjysmën e dytë të shekullit II para e.s., Romakët patën punë edhe me *Ardianët*, një nga popujt e fuqishëm ilirë, që shtriheshin në brigjet e Adriatikut të mesëm, deri në afërsi të liqenit të Shkodrës. Ardianët, që pas vitit 168 ishin futur në njërën nga krahinat e krijuara nga shteti romak, duke

---

<sup>194</sup> Polibi: “*Historiae*” (Historitë), Libri XXXII/13.

parë se mund të mbeteshin edhe të pavarur, dhe se këtë mbase do ta pranonte edhe Roma (pas ndonjë marrëveshjeje të ndërsjellë në formën e ndonjë paqeje afatgjate, ku atyre nuk do t'u nxirreshin kurrfarë telashesh drejt Lindjes), ndryshuan qëndrimin kundër Romës dhe shpallën pavarësinë.

“Shkase” për t'u sulmuar Ardianët, Roma gjeti te “padëgjueshmëria e tyre”, gjë që në tokat e tyre dërgoi legjionet ushtarake, të cilat, bëhet e ditur se vetëm pas disa vite luftimesh, më 135, ia dolën që t'i detyrojnë t'i ulin armët.<sup>195</sup>

Për të shmangur një kryengritje të re, Roma i shpërnguli me forcë Ardianët nga bregdeti në viset e brendshme malore të Hercegovinës së sotme.<sup>196</sup> Ishte kjo pjesë e një strategjie që Roma ndoqi edhe me disa fise të tjera në pjesët qendrore dhe ato lindore.

Por, si do të shihet, Roma do të ketë prapë punë me Dalmatët, Japodët, Liburnët dhe të tjerët, të cilët nuk do të pajtohen me nënshtrimin, ndonëse këto do të jenë luftëra të shkëputura shpeshherë edhe të ashpra, që do t'i marrin bukur shumë kohë dhe energji, meqë një pjesë të mirë të legjioneve do të detyrohet t'i mbajë të lidhura me këto pjesë.

Para se t'u kthehej atyre për herë të dytë, veçmas Dalmatëve të pamposhtur dhe kryengritës, Roma duhej të hiqte disi nga rendi i ditës çështjen dardane, gjë që duhej të kishte punë me mbretërinë e Dardanisë, një fortesë kjo tepër e rëndësishme në mesin e gadishullit, që lidhte pjesët lindore me ato perëndimore, prej nga mbikëqyreshin lumenjtë që derdheshin në Egje, në Adriatik dhe Detin e Zi. Me pozitën e tyre gjeografike Dardanët ngaherë mbanin çelësat e lidhjes së Perëndimit me Lindjen.

Për ndryshim me luftërat me vendet bregdetare ilire dhe ato të Maqedonisë, ku Roma mund të bënte ekspedita kohë pas kohe nga deti, ose me anën e legjioneve të tyre të stacionuara në qytetet bregdetare, ku furnizimi dhe plotësimi i tyre ishte më i lehtë dhe më i shpejtë, lufta me Dardanët, krahas fuqisë së dukshme ushtarake, kërkonte parakushte të tjera që të vihej në veprim kjo makineri. Dhe njëri prej tyre ishte përballimi i aftësisë së madhe mbrojtëse të Dardanëve në rrethanat kontinentale, të cilat, nuk u shkonin për shtati Romakëve, të cilët nuk ishin mësuar me ambiente të tilla.

Pas rënies së Mbretërisë Ilire të Gencit (viti 168) si dhe fushatave të ndërmarra në Veri kundër fiseve të tjera ilire, Roma nuk bëri ndonjë veprim të theksuar ushtarak kundër Dardanëve, ndonëse mbante disa legjione në pjesët e push-

<sup>195</sup> Tit Livii: “*Ab urbe condita*” (Nga themelimi i Romës), Libri XLV/43

<sup>196</sup> Polibi: “*Historie*”, II, f. 9-12.

tuara të Maqedonisë dhe të Greqisë në afërsi të saj. Por, me legjionet “e qeta”, Roma ushtronte trysni te ata, që të mos ndërmerrnin ndonjë veprim që shkonte kundër interesave romake.

Në këtë kohë, Dardanët, edhe pse nuk do të tregojnë ndonjë interesim të theksuar për ndonjë konflikt të hapur me Romakët, megjithatë, nuk do të rrinë duarkryq. Me lëvizjet luftarake herë pas here do të shqetësojnë garnizonet romake në Pajoni, duke ndërmarrë ekspedita që shkonin edhe deri në Astibo dhe Eriqon, siç ndërmerrnin veprime të ngjashme edhe në drejtim të Perëndimit, në drejtim të tokave të Autariatëve për të shkuar në Veri edhe deri te vendet e Skordikeve, me të cilët edhe ashtu Dardanët kishin disa hesape që moti të hapura.<sup>197</sup>

Të ballafaquar “me provokime” të vazhdueshme, pasi që të kenë zhvilluar fushata të shumta kundër Dalmatëve, Japodëve dhe të tjerëve, për të cilat u bë fjalë, Romakët, më në fund, vendosën t’u drejtohen edhe Dardanëve para se të bëhej vonë. Rezistenca e fiseve veriore Ilire në Dalmaci dhe Panoni, tërhiqte vërejtjen se Dardanët mund të ktheheshin në një qendër të rëndësishme të lëvizjes antiromake, e cila do të kishte pasoja të paparashikuara për ta dhe planet e tyre për të nënshtruar gjithë rajonin e Ilirikut. Ky rrezik bëhej edhe më i madh pasi që Dardanët tashmë kishin filluar të lidheshin me fqinjët e tyre lindorë, Medët (fis i madh trakas), të cilët, po ashtu kishin një pozitë të rëndësishme në pjesën lindore të gadishullit. Kështu gjatë viteve 97 e 85 para erës sonë Roma ndërmori disa ekspedita ushtarake drejt Dardanisë dhe Medëve, por nuk ia doli të bëjë gjë.

Dardanët dhe Medët u paraqitën bashkërisht në disa beteja dhe korrën fitore ndaj legjioneve romake, të cilat tërhiqeshin në Maqedoni dhe pjesët e pushtuara të Ilirisë.<sup>198</sup> Në verën e vitit 84 para e.s. Dardanët edhe pa ndihmën e Medëve sulmuan furishëm provincën romake të Maqedonisë dhe arritën deri në Delf.<sup>199</sup>

Fitorja e Dardanëve shqetësoi së tepërmi Romën edhe për faktin se ata tashmë bashkë me Medet dhe Trakasit e tjerë kishin filluar të ktheheshin në një mburojë të fuqishme e cila jo vetëm që i frenonte planet e tyre për t’u zgjeruar më tutje në Veri dhe në Lindje, por edhe t’i mbanin ato që kishin vënë në nënshtrim. Andaj, ishte e pritshme që ata t’u ktheheshin punëve për një fushatë ushtarake të përmasave të mëdha. Në vitin 76 para e.s., Gai Skribon Kurioni u dërgua në Maqedoni në krye të pesë legjioneve të reja, që bashkë me ato që ndodheshin atje, të

---

<sup>197</sup> Droysen, J. G. “*Das dardanische Fürstentum*”, Kleine Schriften zur alten Geschichte Bd. I, Leipzig 1893, faqe 87-94.

<sup>198</sup> Po aty.

<sup>199</sup> Po aty.

fillonin luftën kundër Dardanëve. Vetë autorët antikë bëjnë të ditur se me çfarë frike ishin të kapërthyer ushtarakët romakë çastet që u rreshtuan për luftë kur një legjion i tërë në afërsi të Durrahut ngriti krye për t'u shmangur kësaj lufte.<sup>200</sup>

Përkundër kësaj Gai Kurioni, nga tri drejtime, sulmoi Dardaninë dhe pas luftimeve të gjata dhe tejet të ashpra, me humbje të mëdha për Romakët, ia doli të futet në Dardani. Ndonëse nuk depërtoi në gjithë vendin, megjithatë, duke shkuar rrjedhave të lumenjve Ibër dhe pastaj Moravë, doli në Danub dhe më vonë festoi triumfin edhe në Romë.<sup>201</sup>

Triumfi, qoftë i pjesshëm ndaj Dardanëve dhe Dardanisë, i cili megjithatë, për Romën ishte tejet i rëndësishëm, sepse Mbretërinë Dardane do ta sjellë thujse para shpërbërjes, kishte rëndësi, meqë tashmë ishin hapur rrugët drejt Danubit nëpër të cilat në pjesët lindore nëpër gryka të lumenjve Vardar, Ibër dhe Moravë, mund të depërtohej nga Greqia dhe Maqedonia e pushtuar prej saj në veri-lindje, pra drejtpërdrejt në Traki dhe tutje në viset që synonte.

Ndonëse Dardanët do të vazhdojnë edhe më tutje të rezistojnë, ata tashmë nuk mbikëqyrnin rrugët kryesore lidhëse për në veri, të cilat i kishte në dorë Roma prej nga kishte filluar të krijonte zona të reja administrative në përputhje me konceptin e vet, siç e kishte zbatuar në tokat e pushtuara Ilire, në Maqedoni dhe Heladë.

Që të rrumbullakohet projekti i daljes në Danub dhe Panoni edhe nga ana perëndimore, pra nga vendet e Bregdetit Adriatik për në thellësi, i duhej edhe nënshtrimi i plotë i Dalmatëve dhe fiseve të tjera ilire, që vazhdonin të mbeteshin të shkëputura ose me autonomi të mbikëqyrura, që megjithatë nuk ishin të sigurta. Si Dardanët në pjesën qendrore të Ilirikut, ashtu edhe Dalmatët në pjesën bregdetare dhe atë që çonte kah Danubi dhe Panonia, me shtrirjen e gjerë tejet strategjike, shfaqeshin pengesë kryesore për pushtimet e mëtutjeshme romake. Ndonëse ata kishin marrë disa leksione të përgjakshme, siç kishin qenë ato të viteve 135-130 para erës sonë, megjithatë, ata vazhdonin të bënin pengesa të vazhdueshme në këto pjesë. Këtë më së miri e pohojnë burimet e Romës, të cilat bëjnë të ditur se edhe pas një shekulli të përballjes së përgjakshme me Dalmatët si dhe ndëshkimet herë pas here, që do t'u bëhen, ata vazhdonin të ngrinin armët kundër tyre dhe madje do t'ia dalin që ushtresë romake t'i sjellin humbje të ndjeshme, siç do të jenë ato në vitet 50 para erës sonë kur u thyen forcat që drejtonte konsulli i Cezarit, Aurel Gabina afër qytetit Synodium dhe ai iku i plagosur në Solanë. Të njëjtin fat do të pësojë edhe senatori Balbi (viti 44 para erës sonë) kur

<sup>200</sup> Shih: Frontini "*Stratagema*", cit. sipas "*Historia e Popullit Shqiptar*", vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 152.

<sup>201</sup> Appiani: "*Illyrika*", 6-8.

sulmoi me katër kohortat territoret dalmate por pësoi disfatë të plotë dhe ra në front. Me këtë rast bëhet e ditur se Dalmatët e marrin Salonën dhe disa pjesë të tjera që kishin humbur më parë.<sup>202</sup>

Vetëm pas përballimit të shqetësimeve që solli vrasja e Julius Cezarit, Roma ia doli që të ripushtojë disa nga qytetet dalmate që ata kishin rikthyer në vitet e dyzeta para e.s. Oktaviani dhe Antoni, në vitin 39, kundër Dalmatëve dërguan njësi të mëdha ushtarake të udhëhequra nga poeti Azin Polioni, i cili ndonëse nuk ia doli t'i nënshtrojë në tërësi Dalmatët, megjithatë nga plaçka që kishte marrë atje ndërtoi bibliotekën e parë publike në Romë.<sup>203</sup>

As ky nuk ishte fundi, siç trumbetohej në kryeqytetin perandorak. U desh që pas katër vitesh, legjioneve të shumta të ushtrisë romake t'u prijë vetë Oktaviani, i cili ishte bërë sundimtar i vetëm i shtetit romak. Ushtria që mori me vete përbehej prej 10 legjionesh (1/5 e ushtrisë së përgjithshme romake) dhe, paraprakisht sulmoi në veri tokat e Japodëve, ku bëhet e ditur se njëra pas tjetrës ranë në duart e tij qendrat e tyre: Monetiumi, Avendo, Arupium dhe Terponus për të dalë te Metuli, ku gjendej qendra e Japodëve. Aty u plagos edhe Oktaviani, por Romakët ia dolën ta pushtojnë dhe me këtë të thyejnë rezistencën e tyre.<sup>204</sup> Japodët ishin të pafuqishëm të bënin më shumë përballë armatës romake.

Kur arriti në Sisci dhe e pushtoi këtë qytet prej nga do të ketë një bazë të mirë për të sulmuar Dakët dhe Panonët, Oktaviani, i bindur se fushata do të shkonte mirë, u kthye në Romë. Prapa la Fuf Geminin, por pas disa javësh Oktavianit iu desh sërish të kthehej në Iliri, pasi që aty shpërtheu kryengritja kundër Romakëve. Perandori e pa të udhës që këtë herë vetë të vazhdonte fushatën kundër Dalmatëve, të cilët shfaqeshin nxitësit kryesorë të rezistencës antiromake, e cila rrezikonte të kthehej në një front të gjerë, në të cilin do të përfshiheshin edhe popujt e tjerë përtej Danubit, që tashmë kishin pranuar nënshttrimin.<sup>205</sup>

Këtë herë, ndonëse e nisi mirë me marrjen e Promonës, kur detyroi Verzin të dorëzohet dhe t'ia lëshojë qytetin, perandorit nuk iu dha rasti për një betejë për-

---

<sup>202</sup> Stipçeviq, Aleksandër: "Ilirët", Prishtinë, 1980, faqe 65.

<sup>203</sup> Po aty, faqe 66.

<sup>204</sup> Stipçeviq, Aleksandër: "Ilirët", Prishtinë, 1980, faqe 66.

<sup>205</sup> Më gjerësisht rreth fushatës së Oktavianit në Iliri shih: Johannes Kromayer: "Kleine Forschungen zur Geschichte des Zweiten Triumvirats. V. Die Illyrische Feldzüge Octavians 33 und 34-33 v. Chr." "Hermes", 33-1989; Georg Veith: "Die Feldzüge des C. Iulius Caesar Octavianus in Illyrien in den Jahren 35-33 v. Chr.", Wien, 1914; Erih Swoboda: "Octavian und Illyricum", Wien, 1932; Roland Syma: "Augustus and the South Slavlands" (Revue internationale des études balkaniques, 3/1937-1938, faqe 33-46; Frantz Miltner: "Augustus' Kampf um die Donauzugrenze", 1937; N. Vulić: "Oktavijanov Ilirski rat i izgnanje Skordiska iz Gornje Mizije", Beograd, 1926.



fundimtare, siç e shihte ai. Dalmatët, të udhëhequr nga prijësi ushtarak Testimotisi, vendosën që të bëjnë luftë guerile, pra jashtë një përballjeje frontale, siç kishte ndodhur deri më atëherë. Zunë të sulmonin me grupe të vogla dhe në befasi. Kështu zgjati pothuajse shtatë vjet, por Romakët kishin vendosur që të mos kthehen pa i nënshtuar Dalmatët, ose së paku pa marrë nën mbikëqyrje që të gjitha kalimet strategjike deri te Danubi dhe Drina, të cilat ua siguronin mbikëqyrjen e pjesëve të tjera. Me një durim dhe me shumë humbje, Oktaviani pushtoi qytetet dalmate Synodium dhe Andetrium dhe pastaj arriti të marrë qytetin Setovi, ku ishte përqendruar fuqia kryesore e Dalmatëve. Bëhet e ditur se aty, sërish u plagos Oktaviani, i cili për pak u detyruar të tërhiqet, por u kthye prapë dhe i vuri një rrethim të pakalueshëm qytetit dalmat, i cili u përball me uri, sëmundje dhe telashe të tjera të shumta. Kjo bëri që Dalmatët të dorëzohen. Ky ishte fundi i pavarësisë dalmate dhe fundi i pavarësisë së Ilirëve në përgjithësi.<sup>206</sup>

Fushata e përgjakshme e Oktavianit në Iliri rrënoi përfundimisht që të gjitha strukturat e mbetjeve shtetërore dhe fisnore Ilire, por jo edhe vullnetin e Ilirëve për kundërvënie, që u pasqyrua me kryengritje dhe kryeneçësi të shumta, ndër të cilat më të fuqishmet ishin ato të viteve 6-9 të erës sonë.

Këto kryengritje dhe disa të ngjashme që do të vazhdojnë edhe më vonë, nuk kishin për qëllim rikthimin e shtetit ilir dhe të mbretërive të tyre, që shtriheshin në vende të ndryshme. Ato, në radhë të parë, kundërshtonin politikën e Romës, që kishte të bënte me luftërat e mëtutjeshme, që tashmë kishte nisur në drejtim të veriut kundër Morkomanëve gjermanikë, të cilët kishin krijuar në tokat e Çekisë së sotme një federatë të fuqishme fisnore.<sup>207</sup>

Me këtë rast Roma kishte paraparë një ushtri të madhe prej 12 legjionesh, e cila do të plotësohej me reparte ndihmëse, që do të rekrutoheshin kryesisht te fiset e mëdha të veriut: Dalmatët, Desidiatët, Panonët dhe të tjerët. Meqë këto rekrutime bëheshin me forcë, ishte e pritshme që të merrnin të njëjtën përgjigje. Kështu, të parët reagues Desidiatët, të cilët gëzonin njëfarë pavarësie fisnore. Prijësi i tyre Bato, i cili në saje të sukseseve të shpejta që korri kundër Romakëve ktheu shpresat e fiseve të tjera se mund të bëhej diç më shumë, së paku që të mos përfshiheshin në fushatat luftarake të Romës në veri, të cilat ishin me humbje të mëdha. Ndaj, atij me të shpejtë u bashkuan Breukët me mbretin e tyre Pinesin dhe me prijësin ushtarak që gjithashtu quhej Bato. Dy Batot, me të shpejtë do të kthehen në personalitete qendrore të kësaj kryengritjeje të lavdishme, në të cilën

<sup>206</sup> Stipçeviq, Aleksandër: "Ilirët", Prishtinë, 1980, faqe 66.

<sup>207</sup> Frommer, Hansjör: "Die Illyrer. 4000 Jahre europäischer Geschichte", Karlsruhe, 1988.

një numër i madh fisesh ilire për herë të parë në historinë e tyre, u bashkuan kundër armikut të përbashkët.<sup>208</sup>

Dy Batot morën drejtime të ndryshme, ai i Breukëve në drejtim të Sirminiut (Mitrovica e Sremit), ndërsa ai i Desidiatëve në drejtim të Solanës. I pari që mposhtur, ndërsa i dyti, që plagosur dhe nuk mundi të marrë Solanën, por vazhdoi kah jugu, duke arritur deri në Apoloni në Ilirinë e mesme.<sup>209</sup>

Kryengritja ilire shkaktoi shqetësim të madh në Romë, meqë flitej për përmasa të mëdha të kryengritjes, në të cilat ishin përfshirë 800 mijë kryengritës, me 200 mijë luftëtarë dhe 9 mijë kalorës.<sup>210</sup>

Bëhet e ditur se Perandori August i ballafaquar me rrezikun që kjo ushtri të nisej në truallin italik, i urdhëroi Tiberit që të lidhte menjëherë paqen me Markomanët dhe me Kuadët me të cilët deri atëherë luftoi në mënyrë që me ushtrinë e vet të niset në Ilirik. Atij iu dërgua në ndihmë edhe një tjetër ushtarak i fuqishëm, Germaniku, gjë që nënkuptohej se ndaj kryengritësve ilirë duhej të përdorej e gjithë forca nga të gjitha drejtimet. Beteja vendimtare u zhvillua në lumin Bathius (sipas të gjitha gjasave Bosna e sotme), në të cilën Batua i Breukëve pësoi disfatë të rëndë. Thuhet se mbreti i Breukëve Pinnes kërkonte që të vazhdojë lufta kundër Romakëve, mirëpo kështu nuk mendonte ushtaraku Bato. Ai propozoi dorëzimin, që u pasua nga ushtarët e tij. Mbreti Pinnes po ashtu iu dorëzua Romakëve, kurse Romakët në shenjë mirënjohje e njohën Baton prijës të Breukëve.<sup>211</sup>

Dorëzimi i njërit Baton nuk u miratua nga tjetri, Batoni i Desidiatëve. Kështu, ai iu kthye bashkëluftëtarit të tij, e zu dhe, pasi i bëri gjyq, e dënoi me vdekje. Ky veprim, megjithatë nuk i ndihmoi që t'i kthejë Breukët për vete, kështu që u detyrua të kthehet në Dalmaci, që vetë të vazhdojë luftën kundër Romakëve.<sup>212</sup>

Batoni në Dalmaci pati suksese, të cilat u kurorëzuan me rikthimin e qyteteve Splodum, Sertium dhe disa të tjera, por me të shpejtë u ballafaqua me dy komandantë të fuqishëm të Romës: Germanikun dhe Tiberin, ku ai në Raetinium (Golu-

---

<sup>208</sup> Stipčević, Aleksandër: "Ilirët", Prishtinë, 1980, faqe 68.

<sup>209</sup> Po aty.

<sup>210</sup> Më gjerësisht rreth përmasave të këtyre luftërave shih: Otto Hirschfeld: "Zur geschichte des panno-nisch-dalmatischen Krieges" (Hermes), 25/1890, faqe 351-362; Adolf Bauer: "Zum dalmatinisch-panno-nischen Krieg 6-9 n. Chr.", (Archaeologische-epigraphische Mittheilungen aus Österreich), 17/1894, faqe 153-148; Nikola Vulić: "Dalmatski-panonski ustanak", Glas Srpske kraljevske akademije, libr. 121, 1926, faqe 55-72; Reinhold Rau: "Zur Geschichte des pannonisch-dalmatischen Krieges der Jahre 6-9", CHR. Klio, 19/1925, faqe 313-364; Erich Köstermann: "Der pannonisch-dalmatische Krieg 6-9 n. Chr.", (Hermes), 81/1953, H. 3 faqe 345-378; Tibor Nagy: "Der Aufstand der pannonisch-dalmatinischen Völker und die Frage der Zweitailling Illyricums".

<sup>211</sup> Stipčević, Aleksandër: "Ilirët", Prishtinë, 1980, faqe 69.

<sup>212</sup> Po aty, faqe 69.

biqi i sotëm afër Bihazit në Bosnje), pësoi disfatë të rëndë. Batoni ia doli të largohet dhe të fortifikohet në Andetrium (vend afër Splitit të sotëm në Dalmaci), por edhe prej andej u lagua dhe shkoi në qytetin Arduba, ku u mund përfundimisht.<sup>213</sup>

Pas kësaj humbjeje, ushtritë romake u sollën me ashpërsi të jashtëzakonshme ndaj popullatës Ilire. Ata që nuk ia dolën të fshihen nëpër vise malore, u masakruan tmerrësisht. Në disa pjesë, që të mos u bien në duar Romakëve, gratë ilire u hodhën në gremina.<sup>214</sup>

Roma kishte vendosur që vendet ilire t'i bënte të shkreta, në mënyrë që prej andej të mos i vinin trazira dhe kryengritje që do ta pengonin të shkonte më tutje, siç ishte rasti me depërtimet e tjera në vendet gjermane, ani pse edhe atje, pas humbjes së luftës në pyllin e Tutinburgut, do të detyrohet të ndalet.

Rezistenca e fundit e Batonit të Desidiatëve, edhe pse ishte e fuqishme, megjithatë, nuk mund ta kthente rrotën e historisë prapa, e as të ndryshonte diç në konceptin e Romës për të shkuar më tutje.

I vetmi sukses i saj, nëse mund të thuhet kështu, ishte se forcoi bindjen e Romakëve se ndaj popullatës ilire duhej përdorur strategjia e përvetësimit dhe për-fshirjes së saj në strukturat perandorake, nga ushtria e deri te administrata, në mënyrë që ajo të kthehej në mbështetëse të saj, natyrisht pasi që të bindej se me anën e vetëqeverisjes dhe formave të tjera të ruajtjes së strukturave të veta shoqërore autonome, bëhej pjesë e konceptit të përbashkët perandorak.

## MAQEDONASIT, DARDANËT DHE ILIRËT GJATË PERANDORISË ROMAKE

Me shtypjen e kryengritjes së fundit të Dalmatëve në fillimet e mileniumit të ri përfundon njëra dhe fillon tjetra epokë në historinë e Ilirëve dhe të Dardanëve si popuj kryesorë të trungut të përbashkët nga rrënja Pellazge, të cilët do të vazhdojnë të ruajnë praninë në skenën historike jo më si mbretër në mbretëritë e tyre. Të përfshirë në përbërje të Perandorisë Romake ata do të kenë fatin e kësaj perandorie. Jo rrallë, madje, mu në territorin e saj do të zhvillohen ngjarje me rëndësi

---

<sup>213</sup> Më gjerësisht rreth luftës së fundit ilire kundër Romakëve shih: Nikola Vulić: "*Oktavianov ilirski rat 35-33 i 6-9*", Beograd, 1961, Stefan Josipović: "*Oktavijanovo ratovanje u Iliriku*", Zagreb, 1965; Walter Schmithenner: "*Octavians militärische Unternehmungen in Jahren 35-33 v. Ch.*", Wiesbaden, 1958.

<sup>214</sup> Më gjerësisht rreth represioneve të egra që do të bëjë ushtria romake në viset ilire (Dalmaci) shih Straboni: "*Geographica*" (Gjeografia), Libri VII/ 3-6.

për Romën, ku ata do të kenë rolin vendimtar për zhvillimin dhe mbrojtjen e saj.<sup>215</sup>

Si do të shihet më vonë, aty do të gjejnë mundësi për një bashkim shoqëror dhe politik të përbashkët, që nuk e kishin pasur më parë. Nën ombrellën e një perandorie që ua kishte rrënuar mbretëritë, zë fill edhe fuqia e tyre e madhe për ta ngritur, por edhe për ta përvetësuar nga brenda perandorinë romake brenda një procesi të natyrshëm që, mund të thuhet se nga gjysma e dytë e shekullit të dytë pas erës sonë e këndeje, do të nxjerrë në pah identitetin vetëqeverisës dhe atë shpirtëror (fetar) të Ilirikut, që mund të merret edhe si identiteti i veçantë administrativ madje, siç do të jetë nga shekulli IV pas erës sonë e këndeje, kur pas ndarjes së perandorisë në dy pjesë, me shfaqjen e Ilirikut si njësi e veçantë administrative, ata do të kthehen në faktor kyç të Perandorisë Romake, mbi të cilët do të mbështetet ajo dhe gjithë ngrehina e saj kur fryma perëndimore që bartte ajo, mbështetet mbi konceptin e universalizmit botëror.

Para se të flitet më shumë për këtë zhvillim historik jo gjithaq të rëndomtë, kur i pushtuari kthehet në “pushtues” nga brenda me të cilin do të identifikohet në tërësi, siç do të ndodhë në të vërtetë nga koha e perandorit me prejardhje ilire Dioklecian e këndeje, duhet thënë se Roma, e cila sapo të ketë pushtuar disa nga viset ilire, siç ishin ato nga vitet 168 para erës sonë kur do të mundë mbretin Genc, veptoi me ngulm që pjesët e pushtuara t’i fusë nën administrimin e vet, siç kishte vepruar edhe me Maqedoninë, fillimisht duke i lidhur me njësi të pavarura autonome (*civitate*), e më vonë edhe duke i ndarë në pjesë të veçanta administrative vetëqeverisëse. Madje, edhe vendeve, që për një kohë do t’ua njohë “neutralitetin”, apo atyre që do t’i anashkalojë duke i trajtuar “aleate”, ua imponoi organizimin administrativ dhe format e tjera qeverisëse të ngjashme me atë të Perandorisë Romake në mënyrë që kështu t’i ndihmohej përfshirjes së tyre në hapësirën që ajo e shihte nën ndikimin e saj ose të përfshira në pjesën perandorake, që do të rrumbullakohet qoftë edhe me pushtime luftarake.

Kështu, qysh nga gjysma e dytë e shekullit të dytë, pra nga koha e depërtimeve të para romake në vendet ilire përgjatë Adriatikut, njohim format e caktuara të administrimit civil dhe ushtarak romak në këto pjesë. Por, shtypja e plotë e qëndresës Ilire dhe dardane në gjithë hapësirën e tyre si dhe depërtimet romake në Veri kah vendet gjermane dhe në Lindje kah vendet trake e tutje në Azi të Vogël dhe Lindje të Afërme dhe atë të Mesme, kërkonte një organizim të ri ad-

---

<sup>215</sup> Stipçeviq, Aleksandër: “Ilirët”, Prishtinë, 1980, faqe 68.

ministrativ dhe shtetëror, që do t'i mundësonte një mbikëqyrje të përgjithshme shoqërore, politike dhe ushtarake mbi hapësirën që shtrihej në tri kontinente. Në këto rrethana, shteti skllavopronar romak, përballej me sfidën e madhe të forcimit të brendshëm, që nuk ishte i mundshëm pa përfshirjen e popujve të shumtë që kishte pushtuar dhe pa një zhvillim ekonomik, që të bëheshin pjesë e një civilizimi të ri me pretendime perandorake, ku prona, pushteti dhe mundësia e prosperitetit në të gjitha fushat shfaqeshin si mundësi e re për aristokracinë sunduese të vendit në të cilën duhej të gjenin vend edhe përfaqësuesit e popujve të përfshirë në Perandori, veçmas atyre të Ilirikut.

Vërehet se qysh në fillim shteti romak, në pjesët e pushtuara maqedonase, ilire dhe dardane filloi zbatimin e reformave agrare, të cilat nisën me konfiskimin e tokave më të mira pjellore, të cilat u shpallën "*agerpublicus*".<sup>216</sup>

Natyrisht se kjo reformë, e cila kishte për qëllim që t'i bashkonte pronat e mëdha të tokës në posedim të shtetit, në të vërtetë, mbështetej në favorizimin e qytetarëve romakë, të shumtën kolonëve italikë dhe veteranëve të ushtrisë, të cilët banonin në periferi të qyteteve ose në vendbanimet e veçanta.

Pavarësisht nga synimet e Romës që me anën e politikës agrare të ndikojë që në disa pjesë të ndryshojë strukturën popullore në dobi të asaj që quhej qytetari romak, nga e ashtuquajtura "*agerpublicus*" përfituan edhe vendësit, meqë u krijuan ekonomitë e mëdha bujqësore, të quajtur *latifonde*. Ato gjendeshin pranë rrugëve të mëdha dhe qyteteve, prej nga furnizoheshin me prodhime bujqësore.

Bie në sy se latifondet nuk prekën gjitha pjesët e brendshme të vendit, ku edhe më tutje, në përputhje me marrëveshjet që kishte pushteti qendror i Romës me fiset vendore dhe njësitë që u ishte pranuar statusi i autonomive, toka gjendej në pronësi të bashkësive fisnore ose katundare, të cilat qeveriseshin në përputhje me interesat e tyre, ku megjithatë, fjalën kryesore e kishin drejtuesit e feudeve, të cilët ishin vendorë.

Me ndryshimin e rrethanave, pra kur nëpër viset e pushtuara filluan të përshkoheshin rrugët që ato i lidhnin me pjesët e tjera, gjë që thyhej edhe mbyllja e caktuar, vërehet pranimi i mënyrës së re të posedimit dhe të trajtimit të pronës bujqësore, që do të nxjerrë latifondistë vendorë, të cilët do të përfshihen në sistemin e përgjithshëm. Kështu, nga burimet romake bie në sy se *latifonde* të tilla të mëdha shfaqen edhe në afërsi të Ulpianës, Skupit dhe në shumë pjesë të tjera të Dardanisë, ku njihen edhe patricët e parë nga radhët e parisë skllavopronare siç

---

<sup>216</sup> Shih: Schmit, Rüdiger: "*Illyrië*", Mainz, 1968.

ishte Pompan Atiku dhe familja Ture në Dardani dhe shumë e shumë të tjera të ngjashme.<sup>217</sup>

Para se të kalohet te faktorët shoqërorë, ekonomikë e politikë, që prodhuan rrethanat e reja, të cilat u shfaqën gjatë dhe pas pushtimeve romake nga mesi i shekullit II para e.s. e deri te fillimi i shekullit të parë pas e.s., pra kur do të përmbillet procesi i nënshtrimit të Maqedonëve, Ilirëve dhe Dardanëve nga Romakët, por edhe i popujve të tjerë përreth, është e udhës që të pasqyrohet organizmi administrativ i tyre në përbërje të Perandorisë Romake, me të cilën gjatë katër shekujve të ardhshëm do të ndajnë fatet dhe madje do të kthehen në mbështetës dhe së fundi edhe në mbrojtës të saj kryesorë. Kjo do të ndodhë, ngaqë ishte arritur një shkallë kur perandoria sikur ishte kthyer në interes shoqëror të tyre deri te përmasat identifikuese me të, që doemos duhej mbrojtur nga sfidat që do t'u vijnë nga veriu nga depërtimet e barbarëve (sllavëve, avarëve dhe të tjerëve), që për qëllim kishin rrënimin e qytetërimit të gjithëmbarshtëm të antikitetit në themelet e të cilit qëndronin pikërisht stërgjyshërit e tyre Pellazgët, mbi të cilin do të ndërtohet i gjithë helenizmi.

Me këtë rast, para se të krijohej kjo vetëdije së cilës do t'i duhen rreth pesë shekuj, duhet përkujtuar se hapësira maqedonase dhe ajo ilire-dardane, që u përfshi në përbërje të Perandorisë së Romës pas luftërave të gjata, kaloi nëpër një formë organizative, që nisi nga fundi i shekullit I para e.s. e deri te shekulli i dytë pas e.s., me ç'rast u krijua provinca e Ilirikut (*Iliricum*). Në të u përfshinë krahinat e Ilirisë Veriore. Provinca e Ilirikut përfshinte një territor shumë të gjerë: në Veri arrinte deri në Danub, kurse në Jug deri te lumi Mat; në Lindje provinca e Ilirikut shtrihej deri në Bosfor.<sup>218</sup>

Përmbyllja e pushtimeve, që pasoi nga fillimet e shekullit të parë para e.r., si dhe nevoja që në hapësirat e reja të përfillehin realitetet etnike, ekonomike, por edhe të tjera, të cilat në njëfarë mënyre ruajnë karakteristikat e tyre të njohura, siç ishin edhe në rrethanat e mbretërive dhe të shteteve ilire dhe atij të Dardanisë, shtruan nevojën e një ndarjeje të re administrative. Me këtë rast, bie në sy se Roma krijoi provincën e Mëzisë, ku u përfshi Dardania me gjithë hapësirën e saj. Prej saj pas pak doli me një status si provincë më vete, të cilën Dardania e pati gjatë gjithë kohës, ku kishte një trajtim të veçantë, meqë me të lidhej jo vetëm zhvillimi dhe stabiliteti i Perandorisë së Romës në këtë pjesë, por edhe mbrojtja

---

<sup>217</sup> Fromer, Hansjörgen: "Die Illyer. 4000 Jahre europäischer Geschichte", Karlsruhe, 1988 dhe "Historia e Popullit Shqiptar", vëllimi i parë, Tiranë, 2002, faqe 162.

<sup>218</sup> Laçej, Naim: "Tanagra", Lezhë 2012, faqe 38-48.

nga sulmet barbare nga Veriu (ato avare dhe sllave), ku ata do të kenë një rol të veçantë, siç do ta kenë edhe me rastin e krijimi të Bizantit.

Pak më vonë, veçmas pas luftërave të viteve 6-9, të cilat ishin shumë të ashpra dhe bënë që provinca e Ilirikut, për arsye strategjike, të mbikëqyrej më lehtë, por edhe që të krijohen realitete të ndara etnike, të ndahet në dy sosh: në veri u krijua provinca e Panonisë, ndërsa në jug ajo e Dalmacisë. Krahas këtyre u krijua edhe provinca e Epirit, ku hynë krahinat ilire në jug të Vjosës, i gjithë Epiri dhe Akamania e Etolia, në jug të tij.<sup>219</sup>

Provincat e nënshtuara e të paqësura ishin të mbikëqyrura nga Senati Romak, kurse provincat që kishin rëndësi strategjike, ku gjendja ishte e pasigurt dhe ku kishte nevojë të mbaheshin reparte ushtarake, vareshin drejtpërdrejt nga perandoria. Më vonë ky koncept do të ndikojë edhe në piramidën e drejtimit dhe atë të administrimit perandorak, kur ajo e qendrës që drejtohej nga Roma, do të kalojë te provincat, të cilat shfaqeshin si shtete në shtete, siç ishte rasti me Dardaninë dhe disa të tjera të Ilirisë, prej nga ushtarakët me origjinë vendore, të mbështetur pikërisht nga kjo forcë vendore, do të ngrihen në postin perandorak. Me këtë pushteti faktik i saj vinte nga “periferia” dhe popujt dikur të nënshtuar, ishin kthyer në popuj drejtues, nga sjellja e të cilëve do të varet edhe fati i saj, fakt ky me të cilin justifikohet edhe ai kapërcimi që Ilirët nga të pushtuarit do të kthehen “në pushtues” të brendshëm të Perandorisë. Por, fillimisht në Iliri provinca perandorake ishin Panonia, Dalmacia, Mëzia e Epiri, kurse Maqedonia varej nga Senati.<sup>220</sup>

Në krye të provincave qëndronin sundimtarë të posaçëm, mëkëmbësit, të cilët sipas rëndësisë së provincave ishin të rangjeve të ndryshme. Kështu, në provincën e Dalmacisë mbikëqyrësi ishte në rangun e konsullit (*legatus, Augusti-propraetore*). Provinca e Epirit hynte në grupin e provincave të dorës së dytë dhe sundohej nga mëkëmbës që vinin nga shtresat e kalorësve romakë. Kurse në krye të provincës së Maqedonisë qenë vënë senatorë në rangun e *properatorit*.<sup>221</sup>

Mëkëmbësit emëroheshin në administrimin e provincës për një vit. Ata kishin edhe funksionin e lartë në gjyqësor dhe politikën fiskale. Në provincat ku mbaheshin reparte ushtarake ata kishin në dorë edhe pushtetin ushtarak. Ata kishin *kuestorët*, që merreshin me financat, kish edhe *prokuratorët*, të cilët kryenin punë të rëndësishme në ushtri dhe gjyqe.

---

<sup>219</sup> Po aty.

<sup>220</sup> Shih Ylli, M: “Iliria dhe Epiri”, Tiranë 2007.

<sup>221</sup> Shih Niebur, G. B: “The Roman History”, London 1827.

Me kohë kjo strukturë administrative, gjyqësore dhe ushtarake, e cila kryesisht vinte nga “qendra”, pak nga pak do të plotësohet me vendorë, për të arritur shkallën, ku ata, në disa pjesë, do të jenë përfaqësues të vetëm, meqë i të gjithë sistemi administrativ, gjyqësor dhe ai ushtarak do të bjerë në dorë të tyre, që megjithatë për parakusht kishte që vendorët të fitonin statusin e qytetarisë romake, siç do të ndodhë, në të vërtetë, në vitin 212 pas erës sonë, kur perandori Karakalla shpalli ediktin për këtë.

Vlen të përmendet se Perandoria Romake për vjeljen e taksave kishte një sistem, të ndërtuar mirë, që ato të rridhnin sa më shpejt në arkën e shtetit. Taksa kryesore ishte për tokën dhe për frymën (*tributum soli dhe tributum capitalis*). Në fillim këto taksa paguanin vetëm “*pelegrini*” (të huajt), siç quanin Romakët banorët vendas, por më vonë ato u shtrinë edhe për qytetarët romakë të vendosur në provincat ilire dhe dardane. Një tjetër burim paraqitnin edhe taksat doganore apo të kufirit, që paguheshin për disa mallra të importuara që kalonin nëpër rrugët tokësore, lumore ose detare nga një njësi administrative-doganore në tjetrën. Iliriku përbente një njësi doganore më vete (*portorium Illyrici*), në të cilën qenë përfshirë provinca e Dalmacisë, e Panonisë, e Mëzisë, e Norikut dhe më vonë provinca e Dakisë.<sup>222</sup>

Perandoria e Romës nuk i merrte të gjitha taksat për vete. Një pjesë e tyre u mbeteshin edhe provincave për t’u administruar në përputhje me nevojat e veta, në radhë të parë, për përmirësimin e infrastrukturës së brendshme. Kjo kishte rritur shumë edhe përqendrimin që ato të vileshin sa më mirë, meqë paraqisnin edhe interes vendor. Madje, një pjesë e taksave të përgjithshme që i shkonte Romës, kthehej për hapjen e rrugëve të reja të quajtura perandorake, që lidhnin provincat e ndryshme të perandorisë, të cilat i ndihmuan dukshëm tregtisë dhe qarkullimit të ideve.

Administrimi perandorak kishte lejuar edhe vetëadministrimin e brendshëm të bashkisë të quajtur *civitates*. Në krye të *civitates*-ve ka pasur një prefekt (*praefectus civitatis*), që vinte nga repartet ushtarake të afërta. Me kalimin e kohës, Roma vendosi që prefektët të vinin nga përfaqësuesit e shtresës vendore, pra nga paria, e cila kishte marrë qytetarinë romake. Ata janë quajtur *praepositi* (kryetarë). *Praepositët* kanë pasur edhe një këshill fisnor, i përbërë nga përfaqësues të ndryshëm të parisë vendore - *principes*, prej nga, më vonë, kanë dalë ata që bënë përpjekje për të mëkëmbur perandorinë e hershme romake dhe për të mbajtur gjallë skllavopronarinë që ishte në shturje e sipër.<sup>223</sup>

<sup>222</sup> Shih Malden, H, “*Histori Of Rom*”, London 1830.

<sup>223</sup> Shih: Niebur, G. B: “*The Roman History*”, London 1827 dhe Stipčević, Aleksandër: “*Ilirët*”, Prishtinë, 1980.



Për t'u përmbyllur pamja sado e rrudhur e asaj çfarë paraqiste administrata romake në viset ilire dhe dardane dhe mbi çfarë bazash veptoi, është e udhës të thuhet se organizimi romak në krahinat e mëdha gjuhësore-administrative, të quajtura kuvende (*convetus provinciae*), po ashtu ishte formë e qeverisjes së brendshme, e cila kishte për qëllim që Ilirët dhe Dardanët t'i tërhiqnin në jetën e shtetit romak. Kjo do të tregohet e suksesshme, kur dihet se një pjesë e madhe e Ilirëve dhe Dardanëve brenda një kohe të shkurtër, iu nënshtruan këtij sistemi si në një instrument i rëndësishëm për të depërtuar në hierarkinë më të lartë administrative, politike dhe ushtarake të perandorisë për të arritur edhe në fronin e perandorit. Këto kuvende, jo vetëm që nxirrnin parinë e vendit, por ato po ashtu zgjidhnin për një vit kryetarin e kuvendit dhe priftin e kultit të perandorit.

Në këto rrethana mund të thuhet se në viset Ilire dhe dardane popullsia u përfshi me të madhe në jetën e administratës shtetërore, të ushtrisë dhe në atë ekonomike, meqë ashtu merrte përsipër edhe fatet e veta, së paku, ato që kishin të bënin me çështjet vendore.

Kjo e fundit filloi me ekonomitë e mëdha bujqësore, latifondet, me çka u krijuan mundësitë e mira për prodhime bujqësore, por edhe për përfitime, meqë ekonomitë bujqësore furnizonin qendrat e mëdha, por edhe vetë shtetin, i cili kishte nevoja për to. Kjo bëri që të zhvillohet edhe tregtia, ku krahas prodhimeve bujqësore, qarkullonin edhe mallra të tjera të ndryshme, të cilat, në saje të rrugëve të reja dhe sigurisë që kishin karvanët, ato kalonin lirshëm nga njëra pjesë e Perandorisë në tjetrën.<sup>224</sup>

Ndër këto arterie të mëdha dhe të rëndësishme gjithsesi duhet dalluar ato që shkonin prej bregdetit në brendësi (në drejtimet *Salona-Sirminium*, *Narona-Sirminium*, *Jader-Suiscia*) dhe shumë të tjera nga që nga Senia, Epidaurumi, Scodra dhe qytete të tjera që çonin kah pellgu danubian dhe më tutje kah Lindja, ose nëpër bregdet prej Tergeste nëpër Tarsatikë deri në Jader, Naronë dhe në jug deri në Dyrhachion dhe më tutje kah Helada. Pjesërisht nëpër territoret ilire kalonte edhe *Via Egnatia*, e njohur si një nga rrugët më të njohura romake jashtë Italisë, që shkonte prej Dyrhachiumit dhe Apollonisë deri në Selanik dhe e ndërton Romakët në vijën e rrugës së lashtë nëpër të cilën qysh prej neolitit e tutje shkonin ndikimet kulturore prej Lindjes kah Adriatiku dhe anasjelltas. Një rrugë tjetër tran-

---

<sup>224</sup> Për rrugët në provincën romake, Ilirik, në Maqedoni, Panoni dhe në Mëzi, shih veçmas: Philipp Ballif: *„Römische Strassen in Bosnien und der Hercegovina“*, Wien, 1893; Anton Mollinary: *„Die Römerstrassen in der europäischen Türkei“*, Zagreb, 1914; Esad Pašalić: *„Antička naselja i komunikacije u Bosni i Hercegovini“*, Sarajevo, 1960; Anton Premerstein – Simon Rutar: *„Römische Strassen und Befestigungen in Kraina“*, Wien, 1899; Petrovic, Vladimir: *„Dardania u rimskim itinerarima“*, Beograd 2007.

srajonale me një rëndësi të madhe për vendet ilire dhe dardane ishte ajo që niste nga bregdeti jugor i Adriatikut, kalonte nëpër Lis, kapërcente Drinin dhe dilte në Dardani duke arritur në Naissus (Nishi) prej nga pastaj lidhej me rrugën që vinte nga Veriu (Danubi) nga Singiduni e Viminaici që mbaronte në Thesalonikis.<sup>225</sup>

Krahas ndërtimit të rrugëve të reja si dhe ngjalljes së atyre antike, që lidhnin pjesët perëndimore me ato lindore të perandorisë, ajo mori masa që të aktivizonte edhe rrugët ujore nëpër lumenj nëpër të cilat do të mund të qarkullonin mallrat më lehtë. Kështu, Drini ishte i lundrueshëm në drejtim të Strabonit e deri te Dardania, ndërsa, rrugët ujore shkonin edhe në drejtim të Naissusit.<sup>226</sup>

Këto zhvillime ekonomike sollën ndryshime edhe në jetën qytetare të krahinave ilire dhe atyre dardane, të cilat, të shumtën vetëqeveriseshin. Kështu, krahas qendrave kryesore krahinore, lulëzuan edhe qytetet e tjera, veçmas ato bregdetare, por edhe ato në pjesën kontinentale që lidhnin kalimet e rëndësishme. Edhe këtu rrugët patën një rëndësi të madhe, sepse nëpër to kalonin mallrat tregtare dhe posta. Nëpër ato rrugë, kalonin të gjitha frytet e qytetërimit romak, të cilat mund të thuhet se do të kenë një rol të rëndësishëm edhe në procesin e romanizimit të një pjese të mirë të tokave ilire dhe dardane edhe në pjesët kontinentale. Andaj, në këto rrethana qendrat vendore ishin ato që të parat hetuan ndryshimet dhe ishte e natyrshme që patën një zhvillim të ndjeshëm, pse krahas rëndësisë administrative dhe ushtarake, ato njëherësh u kthyen edhe në akumuluese të një pjese të mirë të popullatës, e cila zbriste nga fortesat e dikurshme malore dhe vendbanimet e largëta, të cilat kishin mbetur të shkëputura, për ta derdhur energjinë e vet në një hapësirë urbane, me anën e së cilës krijonte edhe perspektivën më të mirë.

Forcimi i qendrave të reja urbane, ku vërehej mënyra romake e jetës, meqë ato u nënshtroheshin modeleve perandorake, pastaj humbja e rëndësisë së disa vendbanimeve të fortifikuara në pjesët kodrinore-malore, megjithatë nuk ua humbi rëndësinë shumë qyteteve ilire, veçmas atyre bregdetare, të cilat ruajtën qeverisjen autonome bashkë me traditat sociokulturore, ku madje preheshin edhe monedhat e tyre deri nga fillim të shekullit III të erës sonë. Ndër këto ishin Apolonia, Amantia, Foinika, Skupi dhe Naissus në Dardani e të tjera.<sup>227</sup>

Në këto qytete, krahas kolonëve, ushtarakëve kolonë dhe italikëve kolonë, që do të fillojnë të vendosen në qytetet e rëndësishme ilire dhe dardane si treg-

---

<sup>225</sup> Stipčević, Aleksandër: "Ilirët", Prishtinë, 1980, faqe 72.

<sup>226</sup> Shih: Strabon: "Geografia", VII, f. 5,7.

<sup>227</sup> Petrović, Vladimir: "Dardania u rimskim itinerarima", Beograd 2007.

tarë, ndërmarrës ose administratorë, të cilët përbënin atë që tashmë paraqitej si elitë nga radhët e qytetarisë romake, shfaqeshin edhe Ilirët dhe Dardanët e pasur, numri i të cilëve sa vinte e rritej, që i takonin shtresës skllavopronare ose parisë së vjetër fisnore. Meqë kishin marrë qytetarinë romake, kishin fituar edhe të drejtën që të futen në elitën e vendit.

Këtu, në të vërtetë, e ka prejardhjen fillimi i përfshirjes së Ilirëve dhe Dardanëve në hierarkinë e lartë qeverisëse dhe administrative të Perandorisë, ku shumë prej tyre do të përfshihen në jetën ekonomike, shoqërore, politike por edhe atë kulturore të vendit deri në nivelet më të larta ushtarake dhe politike, rrugë kjo e suksesshme, që do të kurorëzohet edhe me arritjen deri te fronin perandorak.

Natyrisht se ky zhvillim nuk do të mund të ishte i përmasave të gjera dhe, po ashtu nuk do të mund të ishte i thellë për nga pikëpamja shoqërore, ekonomike, kulturore dhe politike madje, po qe se nuk do të ishte me vulën e *qytetarisë së lirë*, që do të përfshinte një pjesë të mirë të popullsisë, e cila nga ky status, në radhë të parë përfitonte, nga pikëpamja shoqërore dhe ekonomike, por edhe ajo politike.

Edhe pse Perandoria Romake pas zgjerimeve në Lindje dhe Perëndim do të ruajë elementet e shoqërisë skllavopronare dhe, në njëfarë mase në disa segmente atë do ta thellojë, megjithatë në pjesët e Ilirikut dhe të Dardanisë, popullatës do t'i ofrohet statusi i popullsisë së lirë, që përbënte një parakusht të rëndësishëm që të fitonte atë të *qytetarisë romake*, status ky që kalonte nëpër atë me të drejta qytetare. Të tillë do të jenë pronarët e vegjël të tokave, zejtarët dhe tregtarët e shumtë. Bëhet e ditur se në krahinat ilire dhe ato dardane, krahas qyteteve-koloni, të cilat ofronin mundësi të mira zhvillimi dhe ngritjeje për shtresat e dalluara shoqërore prej nga ato mund të kyçeshin në jetën e gjerë perandorake, do të jenë të ashtuquajturat *municipe*, si qendër - banimesh lokale, të cilat do të krijojnë bërthamën e popullatës së lirë, ku ajo gjente interesat e veta ekonomike, por edhe shoqërore e kulturore njëherësh.

*Municipet* kanë pasur një vetëqeverisje të rëndësishme vendore, ku tregtarët, zejtarët dhe të tjerët që përfshiheshin në këto veprimtari ekonomike vendosnin për interesat e tyre, meqë u mbetej edhe një pjesë e taksave që ta përdornin për nevojat e tyre. *Municipe* ka pasur edhe në vise të brendshme, disa prej të cilave kanë qenë të lidhura me minierat, të cilave perandoria u ka kushtuar rëndësi të madhe, meqë prej tyre siguronte sasi të mëdha mineralesh. Si të tilla, ato i nënshtroheshin një mbikëqyrje të përhershme ushtarake.<sup>228</sup>

---

<sup>228</sup> Malden, H, "Histori Of Rom", London 1830.

Një *municip* i tillë, krahas Naisusit, ka qenë edhe Ulpiana në Dardani (afër Prishtinës).<sup>229</sup> E ngritur në këtë rang në fillim të shekullit II të erës sonë. Më pas, të njëjtën shkallë do ta fitojë edhe vendbanimi i Soçanicës (Municipium Dardanorum), por asaj shpejt do t'i humbet rëndësia, ngaqë pas reformave të Aurelianit, kur pas shkëputjes nga Mezia, u fuqizua provinca e Dardanisë, Ulpiana, në vitin 343, u kthye në qendër të peshkopatës.<sup>230</sup>

Krahas *municipeve*, disa prej të cilave, në saje të zhvillimit ekonomik, u ngritën në bashkësi qytete të rangut romak të një rëndësie të veçantë ushtarake, siç ndodhi me Skupin,<sup>231</sup> në Iliri dhe Dardani vërehet edhe prania e qendër-banimeve të fortifikuara, të cilat u quajtën *castellaose opida* (kështjella apo qyteza), banorët e të cilave fillimisht nuk kishin të drejtën e qytetarisë romake, por më vonë, pas ediktit të Karakallës të vitit 212, edhe atyre do t'u jepet kjo e drejtë, e cila do të ndikojë për të mirë në statusin e tyre shoqëror dhe ekonomik. Në këto kështjella e qyteza, të shumtën, shfaqeshin si qendra të njësive të brendshme të *civitaveve*, ku gjendej paria vendase dhe autoritetet provinciale të perandorisë, të cilat për shumëçka ishin të pavarura.<sup>232</sup>

Ruajtja e vendbanimeve të fortifikuara në disa krahina ilire dhe veçmas në Dardani, ku në të vërtetë, u ruajt dhe u forcua, ai që në njëfarë mënyre mund të quhet *identitet etnik*, por tash jashtë shkapërderdhjeve të njohura fisnore që e karakterizonte Ilirikun pararomak, ka të bëjë me një strukturë të caktuar urbane, karakteristike për vendet kontinentale, ku gërshetohen elementet shoqërore me ato të sigurisë, të cilat kishin rëndësi për perandorinë, e cila në ato pjesë do të përballlej me sulmet e ndryshme dhe të shumta të popujve barbarë që vinin nga

---

<sup>229</sup> Ulpiana njihet si njëra ndër qendrat kyçe që lidhte rrugët midis Lindjes dhe Perëndimit. Gjurmët e para të civilizimit në Ulpianë janë dëshmuar nga periudha e hershme parahistorike, ndërsa formën e urbanizuar Ulpiana e arrin në fund të shekullit të parë të erës sonë. Gjatë periudhës romake, ishte njëra ndër qendrat kryesore ndërlidhëse midis Konstantinoplit dhe Romës dhe pranë saj bëhej kryqëzimi i rrugëve që lidhnin dertin Adriatik me detin Egje dhe tërthorazi edhe me Detin e Zi. Në vitin 169 pas erës sonë Ulpiana fiton statusin e municipit (Municipium Ulpianium), ndërsa zhvillimin më të madh e ka arritur në periudhën në mes të shekujve III dhe IV pas erës sonë, kur ajo do të shndërrohet në një qendër të fortë ekonomike, kulturore por edhe politike. Për këtë flet edhe statusi Municipin Splendissima. Në atë kohë Ulpiana kishte rrugë të drejta, ujësjellës si dhe objekte publike, sarkale. Gjatë kohës së perandorit Justinian, në shekullin VI, rimërohet Justiniana Secunda.

<sup>230</sup> Petrović Vladimir: “Dardania u rimskim itinerarima – gradovi i naselja”, Beograd 2007. Faq8 97.

<sup>231</sup> Skupi, ndër qytetet më të rëndësishme të Dardanisë antike, që e përmend edhe Ptolemeu, dhe sipas të gjitha gjasave gjatë kohës romake edhe qendra administrative e provincës së Dardanisë, në kohën e perandorit Vespazian u kthye në një koloni të madhe ushtarake romake, në të cilën ishin të vendosur veteranët të legisë VII të Klaudios. Ndër këta veteranë, të cilët, në kohën e Mark Aurelit do të fitojnë të drejtën e qytetarisë romake, një pjesë e mirë e tyre ishin me prejardhje nga Skupi. Prejardhja e tyre dardane dëshmohet me enrat karakteristike dardanë: *Bithus, Daizo, Dassius, Metrius, Mestula, Sauso* e të tjerë. (Shih: V. Petrović: “Dardania u rimskim itinerarima”, Beograd 2007, faqe 105).

<sup>232</sup> Po aty, faqe 98.

Lindja dhe herë pas herë futeshin në hapësirën perandorake duke e rrezikuar me të madhe sigurinë e saj si dhe mirëvajtjen e jetës ekonomike. Nga kjo pikëpamje, edhe në rrethanat e reja perandorake, Dardania do të ruajë shumëllojshmëri nga mënyra e jetës, meqë kjo i shkonte për shtati edhe Perandorisë Romake, e cila këtë provincë, që fillimisht e kishte përfshirë në atë të Mëzisë së epërme apo superiore, që më vonë të shfaqet si provincë më vete, e vlerësonte si shumë të rëndësishme nga pikëpamja e sigurisë.<sup>233</sup>

Ajo pos që lidhte pjesët lindore me ato jugore dhe perëndimore të Ilirisë dhe të Maqedonisë me Heladën, njëherësh lidhte edhe ato qendrore me veriun deri në Danub, duke mbikëqyrur kështu rrjedhat kryesore të lumenjve (Moravë, Ibër, Drin dhe Vardar), siç lidhte edhe rrugët perandorake që shkonin nga lindja në perëndim dhe anasjelltas, por edhe ato që në Ulpianë ose Naissus (Nish) degëzohe-shin për në Lindje apo Juglindje.

Prandaj, urbanizimi i Dardanisë në rrethanat e pushtimit romak, i nënshtuar më pak zbatimit të politikës “*Pax romana*” e më shumë ruajtjes së bazës ekonomike dhe shoqërore, kishte qëllim mbajtjen e elementit autokton në kuadër të strukturave të tij të kahershme, të cilat do t’u hynin në punë edhe atyre perandorake të natyrës ekonomike, por edhe më shumë atyre strategjike.

Këtë e vërtetojnë edhe dëshmitë e ndryshme arkeologjike në hapësirën e Dardanisë (edhe pse besohet se shumëllojshmëri e tyre ka mbetur e pazbuluar dhe e pahulumtuar), siç janë ato në Therandë (Suha Reka e dikurshme,<sup>234</sup> *Municipium DD Soçanica*), ku shihet vazhdimësia topike dhe ajo etnokulturore.<sup>235</sup>

Nga këto hulumtime mund të kuptohet se elementet autoktone të vendbanimeve protourbane në masë të madhe ruhen edhe në kohën e puqjeve me elementet e huaja, veçmas të atyre urbane, që vinin nga Roma, që i nënshtroheshin konceptit strategjik dhe ekonomik perandorak. Dardania si vend entitet i veçantë, kishte një rëndësi të madhe, gjë që më së miri do të pasqyrohet me statusin ad-

---

<sup>233</sup> Më gjerësisht rreth paraqitjes së Dardanisë si provincë në vete, e cila shfaqet në kohën e Aurelianit, nga fillimet e shekullit IV pas erës sonë shih: M. Fukss: “*Moësie*”, PWRE XIV, 1928, col. 2389-2390. Sipas këtij autori kufijtë administrativë dhe të provincës së Dardanisë gjatë kohës së Perandorisë Romake, ishin dukshëm më të ngushtë se ata etnikë, që megjithatë në perëndim përfshinin pjesët nga malet e Sharit e deri përtej Nishit, ndërsa në veri shkonin rrjedhës së lumit Iber dhe Morava Jugore deri tutje Moravës Perëndimore duke përfshirë krahinën e Timokut që shkonte deri në Daki, ndërsa në jug shtrihej nga derdhja e epërme e Vardarit deri në Vodno dhe më në jug te Byzolorsi (Velesi i sotëm në Maqedoni).

<sup>234</sup> Më gjerësisht shih: N. Slavković-Djurić: “*Ilirski tumuli kod Suve Reke*”, në GMKiM. IX/1964, faqe 537-549; E. Cerskov: “*Municipium DD kod Soçanice*”, Prishtinë-Beograd, 1970; Esad Pašalić: “*Period vladavine do kraja III vjeka naše ere*”, në “*Kulturna istorija Bosnje i Hercegovine*”, 186-187; M. Suić: “*Problems de Palegenese et d’urbanisation des centres illyriens*”, në St. Alb.X (2) 1973, faqe 105-116.

<sup>235</sup> Mirdita, Zef: “*Studime dardane*”, Prishtinë, 1979, faqe 112.

ministrativ dhe politik si provincë më vete, që e fitoi kur Perandoria do bindet se kjo pjesë ruante çelësin e sigurisë së pranisë së saj në këtë nyje rajonale. Kjo shihet qartë te mënyra e zhvillimit të sistemit të vendbanimeve të tipit *castella, urues, stationes, villae, canaboe* (Timocum minus e Timocummaius te Knjazhevci në Serbinë e sotme), që kanë qenë subordinuar për qëllime ekonomike e strategjike.<sup>236</sup>

Megjithatë, karakteristika themelore e urbanizimit të trevave të Dardanisë, së paku sa u përket shekujve III dhe IV të erës sonë, shihet në faktin se vendbanimet, siç bëhet e ditur nga të dhënat e itinerareve, janë të përqendruara gjatë rrugëve dhe në regjionet e pasura me xeherore (Ulpiana, Municipium DD te Soçanica), kurse nga ana tjetër vetë themelimi i tyre, duke përfshirë edhe koloninë Scupi, nuk është bërë në bazë të deduksionit. Paraqitja e këtyre tri qendrave në pjesën qendrore të Dardanisë bashkë me Naissus<sup>237</sup> dhe Arribantion në pjesën lindore nuk do të thotë se vetëm këto katër-pesë qytete kanë paraqitur reliefin urban dhe administrativ të Dardanisë. Kështu, në rrugën Naissus – Ulpianë kemi vendbanimin e njohur antik Vicijanum<sup>238</sup>, si dhe Therandën<sup>239</sup> në pjesën perëndimore që këtë hapësirë, nëpër pjesët malore, e lidh me Skupin. Përkundrazi, ato janë të pashmangshme në të gjitha kronikat dhe hartat, se janë pararomake, pra që vijnë nga koha e antikitetit klasik (shekujt VII-I) para erës sonë, duke e ruajtur vazhdimësinë e tyre në saje të rëndësishme që kishin. Nga burime romake mësohet se edhe rrafshi i Dukagjinit dhe pjesët e tjera kishte qytete, kështjella dhe vende

---

<sup>236</sup> Po aty, faqe 113.

<sup>237</sup> *Naissus* (Nishi i sotëm), paraqet njërin ndër qytetet më të rëndësishme dardane nga antikiteti i hershëm, që si i tillë zihet ngojë edhe nga Ptolemeu. Si vendbanim, Naissusi përmendet në shekullin III para erës sonë. Sipas disa të dhënave ky vendbanim, midis shekujve III dhe II para erës sonë ishte një pikë e pashmangshme konfrontimesh midis Dardanëve dhe Skordikëve. Naisus do të bjerë në duar të Romakëve pas humbjes përfundimtare të Dardanëve, ndërkohë që sipas disa burimeve romake në kohën e Tiberit ai do të kthehet në një koloni ushtarake prej nga trupat romake dërgoheshin për në Lindje. Në kohën e Augustit aty do të qëndrojnë Legjioni IV skit dhe ai V maqedon. Në mesin e shekullit II, Naissus në kohën e luftërave narkomane ishte qendra e mbrojtjes së Dardanisë veriore. Aty u formua dhe qëndroi kohorta Aurelit I Dardanorum si dhe kohorta e parë e Dardanëve. Këto kohorte, pos tjerash, kishin për detyrë transportin e mineraleve, ruajtjen e xeheroreve në Dardani si dhe sigurimin e rrugëve që çonin nga Danubi për në Skup dhe Lissus si dhe rrugëve të tjera drejt lindjes. Në afërsi të Naissusit, si suburbium (paralagje) ishte dhe Mediana, një rezidencë antike.

<sup>238</sup> *Vicijanum* (Vushtria e sotme), sipas itinerareve romake ishte 79 milje ose 117 km larg Naissusit në drejtim të Lissusit dhe fare në afërsi të Ulpianës. Ky vendbanim kishte një rëndësi ushtarake, por edhe ekonomike, meqë lidhte rrugët e luginës së Ibrit në veri, por edhe ato që në jug shkonin për në Skup dhe Lissus, si dhe një rrugë tjetër kah perëndimi, nëpërmes Sribinit (Foqës) për në pjesën e Neretvës në Adriatik. (Shih: Mirdita, Zef: "Studime Dardane", Prishtinë, 1979, faqe 129-141; Jovanović, B: "Stratigrafija naselja Vinčan-ske grupe kod Kosovske Mitrovice", në Glasnik Muzeja Kosova i Metohije VI-1961).

<sup>239</sup> *Theranda*, vendbanim i cili mund të lidhet edhe me *Thermidova* që e përmend Ptolemeu, po ashtu paraqet një qendër të rëndësishme antike. Sipas tabelave romake ajo ishte 104 milje (154 km) larg Naissusit (Nishit). Ubikacioni i saj lidhet me trekëndshin midis Suharekës së sotme, Lubizhdës dhe Prizrenit. Në të ishin të stacionuar legjioni VII i Klaudit dhe legjioni IV i Flavijes. (Shih: Mirdita, Zef: "Studime Dardane", Prishtinë, 1979, faqe 129-141; Djurić – Slavković, Nataša: "Ilirski tumuli kod Suva Reke", në Glasnik Muzeja Kosova i Metohije IX/1964).

të tjera me tretmanin e bashkësive fisnore *municipale*, gjegjësisht *civitates*, ku tashmë në saje të materialeve epigrafike janë dëshmuar dy në trevën Sopjinë-Popovljan-Mushitishtë, 18 kilometra në verilindje të Prizrenit<sup>240</sup>, dhe tjetri te Dërsniku i Ulët, në afërsi të Klinës.<sup>241</sup>

Po ashtu, bëhet e ditur edhe për një qendër municipale me karakter *civitas* në Dardani, diku në afërsi të Kllokotit, jo larg Vitisë, burimet termale të së cilës kanë qenë të njohura që në antikë dhe, po ashtu bëhet e ditur edhe për disa qendra të tjera *civitatese* dhe në viset e tjera të Dardanisë, siç ishin ato territoriale fisnore, njëra në trevën e Leshakut të sotëm, tjetra në luginën e Kumanovës, kurse e treta e Moravës Jugore me qendrën kryesore në Davidoc,<sup>242</sup> qendra këto të natyrës administrativo-juridike (*bordo decurionum duoviri iure dicundo*), në të cilat popullsia vendase ka jetuar larg ndikimit të romanizimit, gjë që kjo ka penguar jo vetëm romanizimin, por edhe përfshirjen e tyre të gjerë në dinamikën e zhvillimit shoqëror dhe politik perandorak, siç ndodhte me krahinat tjera.

Arsyet për një “ngecje” të tillë, që ka shkuar në të mirë të ruajtjes së elementeve etnokulturore te Dardanët, ndoshta duhet kërkuar edhe te vetë strategjia e Romës, që në këto pjesë të ruhet etnosi vendor (pra ai autokton dardan), meqë vetëm ashtu ai mbahej i lidhur për tokën e vet dhe ambientin, e me këtë provincës i ruhej aftësia mbrojtëse, që më vonë, në rrethanat e plasaritjeve të brendshme dhe sulmeve barbare nga veriu, do të tregohet vendimtare për mbijetimin e më-tutjeshëm të Perandorisë, qoftë edhe në formën e Bizantit, që do të shfaqet nga shekulli V pas erës sonë e tutje, i cili edhe për afër dhjetë shekuj do t’ia ruajë ngrehinën civilizimit perëndimor në këto pjesë.

## ROMANIZIMI DHE IDENTITETI ETNIK ILIR-DARDAN

Ajo që do të shihet si interes i Ilirëve dhe Dardanëve për mbrojtjen e gjithë-mbarshme të ngrehinës së Perandorisë Romake, që njëherësh ishte edhe një luftë për mbrojtjen e vendit të tyre, jo rrallë lidhet me romanizimin si një proces të natyrshëm, që kishte përfshirë edhe Ilirët, Maqedonasit dhe Dardanët, siç kishte përfshirë thuajse që të gjithë të tjerët që ishin kapërthyer në përbërje të perandorisë së madhe dhe, kush më shumë e kush me pak, kush më herët e kush më

<sup>240</sup> E. Čerskov: “*Rimljani na Kosovu i Metohiji*”, Beograd, 1969, faqe 40-41.

<sup>241</sup> Po aty, faqe 116.

<sup>242</sup> Ivan Mikulčić: “*Teritoria Skupa*”, Shkup, 1971.

vonë, do t'i nënshtrohen kornizës së saj shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore në përputhje me rrethanat dhe interesat e tyre.

Të kuptuarit e këtij fenomeni mbi këto baza, jo gjithnjë është parë në përputhje me vetë natyrën e çështjes dhe realitetet e krijuara. Prandaj, jo rrallë, nga interpretime të njëanshme janë krijuar edhe dilema të paqëndrueshme, të cilat janë kthyer në stereotype thujse të pakalueshme kuturu, të natyrës bardh-zi. Të këtilla janë edhe ato që kanë të bëjë me romanizimin të Ilirët dhe Dardanët si dhe kahun e tij, i cili është parë “një si letër e bardhë” pse “një mori fisesh të shkapërderdhura dhe të shumtën të armiqësuar me njëri-tjetrin” nuk kanë pasur çfarë të mbrojnë, e as të mbajnë gjë prej gjëje<sup>243</sup>, e deri te vlerësimet se “ata janë akomoduar aq mirë në strukturat ushtarake dhe politike të Perandorisë Romake, sa që dikur janë kthyer në mbrojtës të saj, siç kishte ndodhur në luftën kundër sulmeve barbare, ngase kanë luftuar për ta mbrojtur pushtetin e fituar në saje të fuqisë njerëzore, e të ngjashme<sup>244</sup>.

Këto dhe vlerësime të ngjashme jo vetëm që janë larg të vërtetës historike, por njëherësh edhe absurde, sepse po të ishte siç thuhej “se nuk kishte se çfarë të mbrohej”, atëherë pse do të ndodhnin luftërat rreth dyshekullore të Romakëve për të pushtuar tokat ilire, Maqedonase, ato dardane dhe të tjerat në anën tjetër të Adriatikut, që kishin filluar nga mesi i shekullit të dytë para erës sonë dhe do të përfundojnë në fillim të shekullit të parë pas erës sonë? Po ashtu, janë larg të vërtetës edhe ato që quhen “akomodim i vullnetshëm i Ilirëve” në perandorinë e re pse nuk kanë pasur çfarë të ruajnë e as çfarë të humbin! Sepse, po të ishte ashtu, atëherë a do të kishte nevojë që Perandoria Romake, edhe pasi të pushtojë tokat e tyre me aq shumë gjak, do të pranojë por edhe do të ruajë shumëçka të organizimit të tyre etnik dhe kulturor nga vetëqeverisja fisnore, jeta ekonomike e deri te struktura urbane, të cilat, nga pikëpamja politike do të sanksionohen me organizimin administrativ në provinca në baza të vetëqeverisjes së gjerë, ku Iliriku bashkë me Dardaninë do të kenë tretman të veçantë, pjesë të të cilave kanë qenë thujse shtete në shtet?

Nëse çështjet që kanë të bëjnë me ngritjen dhe rënien e Perandorisë Romake nga zanafilla e deri në fund, shikohen nga pikëpamja e faktorëve përbërës të saj, atëherë del se Ilirët dhe Dardanët mund të merren edhe si themelues të saj, vetëdije kjo që ka funksionuar dyanshëm. Burimet antike, veçmas ato që vijnë nga

---

<sup>243</sup> Më gjerësisht shih: Garašanin, Milutin: “*Istorijska i arheološka razmatranja u Ilirskoj državi*”, Beograd, 1974; Geza, Alföldy: “*Die römische Gesellschaft-Struktur und Eigenart*”, 1975;

<sup>244</sup> Më gjerësisht shih: Hans Ulrich Istinaky: “*Sicherheit al politisches Problem der römischen Keisertum*”, Baden-Baden, 1952; I. M. Rostowetz: “*Gesellschaft und Wirtschaft der Römische Staat*”; A. Morsey: “*Untersuchungen zur Geschihte der römischen Provinz Moesia superiore*”; Gavela, Branko: “*O Ilirskom substratu na Balkanu*”, Beograd, 1965.



autorët e rëndësishëm antikë, që nga ato letrare nga Homeri<sup>245</sup>, Hesiodi<sup>246</sup>, Virgjili<sup>247</sup> e të tjerë dhe historianët, gjeografët, filozofët dhe kronikët e ndryshëm: Herodoti, Tukididi, Isokrati, Skylaksi, Skymna, Polibi, Apollodori, Strabonoi, Plini, Lukiani, Ptolemeu e të tjerë<sup>248</sup> ofrojnë shumë të dhëna që kanë të bëjnë me rolin e Dardanëve dhe të Etruskëve në themelimin e Romës dhe pastaj ngritjen e saj prej Etruskëve dhe fiseve të tjera pellazge që ishin atje nga koha parahistorike.

Siç u pa në kapitujt paraprakë, burimet letrare, që vijnë nga Homeri e deri te Virgjili, ndonëse të ndërlidhura me imagjinatën krijuese, fokusojnë luftën e Trojës dhe fatin e trojanëve (kryesisht Dardanëve), të cilët do të drejtohen rrugëve tokësore (nëpër Epir), siç e kishte bërë Eneu, në mënyrë që pastaj prej andej të kalojnë në jug të Italisë, ku pasi që do të vendosen do të themelojnë Romën. Versioni letrar, që mbështet në burime të caktuara, gjen mbështetje edhe te le gjendat romake, por edhe nga kronikat e ndryshme romake, ku vazhdimisht themelimi i Romës lidhet me kapërcimin e Eneut dhe trojanëve të tjerë në Itali, të cilët humbjen e Trojës do të mundohen ta zhdëmtojnë me ndërtimin e një tjetre në Perëndim, siç do të veprojnë në të vërtetë. Diçka e kësaj vetëdije, me siguri se si kujtesë historike apo e ngjashme duhej të ketë mbetur dhe vepruar edhe tek stërnipërit e Eneut, të cilët ndonëse kanë themeluar Romën, ata gjithnjë kanë pasur mendjen se duhej kthyer te Troja, pra te rrënja e tyre që një ditë ta ngjallin shpirtin e saj, siç do t'i lidhej për mendje Kostandinit të Madh, një Dardani nga Naissusi i cili do ta kthejë qendrën e perandorisë së madhe nga Roma në Bizant, fare afër Trojës, që atje edhe për një mijë vjet t'ia zgjasë jetën Perandorisë Lindore. Bartja e kryeqendrës nga Perëndimi në Lindje, pra nga Roma në Kostandinopojë nuk ishte vetëm çështje e një vendimi strategjik, që perandorit të madh nga Dardania do t'ia diktojnë rrethanat e mbijetimit në kohën kur shoqëria skllavopronare ndodhej në shkallën më të lartë të krizës pikërisht pse duhej të hiqte dorë nga ky rend shoqëror të cilit i kishte kaluara koha, por edhe një si amanet për t'iu kthyer rrënjës, që Kostandinit do t'i shndërrohet në obsesion. Tek e fundit, këtë ndjenjë a nuk e kishin edhe të gjithë ata perandorë Ilirë-dardanë të cilët Bizantin do të ngritin deri në atë masë sa ai të quhet edhe “Bizanti ilir”<sup>249</sup>, themel i të cilit, nga shekulli IV pas erës sonë e këndej në Ilirik, ishte Dardania dhe

---

<sup>245</sup> “*Iliada*”, “*Odissea*”, Tiranë, 1979.

<sup>246</sup> Hesiodi: “*Theognia*”, fragment, 134 te *Sämtliche Werke (Theogonie, Werke und Tage)*, Dieterich'sche Verlagsbuchhandlung (Band 38), Wiesbaden 1947.

<sup>247</sup> Virgilius: “*Aeneidos*”, (Eneida), Libri III.

<sup>248</sup> Më gjerësisht vlerësimet e autorëve antikë shih te: “*Ilirët dhe Ilira te autorët antikë*”, Prishtinë, 1979.

<sup>249</sup> Budimir, Milan: “*O etničkom odonosu dardanaca prema Ilirima*”, Beograd, 1950.

Dardanët me krishterimin si postulat, që së pari do të pranohet prej tyre në mënyrë që pastaj të pranohet edhe prej të tjerëve (Grekëve, Romakëve e deri te Sllavët që do ta pranojnë pas shtatë shekujsh) për t'u kthyer kështu në një emërues të përbashkët shpirtëror të një qytetërimi që ishte i ndryshëm nga ai perëndimori?

Edhe pa hamendësimet e kësaj natyre, të cilat mbështeten në burime letrare dhe ato mitologjike që vijnë nga antikiteti dhe tashmë si të tilla i takojnë kujtesës njerëzore, edhe ato historike nga antikiteti nuk e mohojnë kapërcimin e Eneut dhe trojanëve të mundur (Dardanëve) në jug të Italisë si dhe vendosjen e tyre atje si një fillim të ri, siç nuk e mohojnë as praninë pellazge në këto pjesë nga koha e parë e lëvizjes së popujve në kapërcylin midis mileniumit të tretë dhe të dytë e deri te ai i pari. Ndonëse të shkapërderdhura, nga pikëpamja faktografike, mundësojnë mbindërtimin e kësaj ngjarje. Madje, ky “detaj”, nuk do të harrohet as nga historianët e shekujve të mëvonshëm, pale se shumë prej tyre nuk e ndjekin më tutje me përpikëri rrjedhën historike të këtij zhvillimi. Ose edhe kur këtë e bëjnë, largohen nga ky faktor, nga shkaku i vetëm që Perandoria Romake të mos shihet në vazhdimësi me një qytetërim lindor, siç ishte ai i Trojës antike, por si një koncept perandorak universal perëndimor që do të lindë si antipod i tij.

Gjithnjë bazuar në këto të dhëna historike që vijnë nga autorët antikë dhe historiografia e kohës së re nëse nuk ka qenë në gjendje t'i pranojë në tërësi, e as t'i mohojë, krahas Eneut dhe trojanëve, të cilët do të barten në jug të Italisë, ku fiset dardane Galabrët, Thunanët dhe Daunët do të vazhdojnë dinastitë e tyre në Kalabri dhe Sicili dhe në gjithë jugun italian, të cilëve edhe më vonë do t'u bashkohet popullata e Peloponezit dhe Epirit (shpërngulje kjo që me intensitete të ndryshme do të vazhdojë edhe deri në Mesjetën e vonshme për të arritur kulmin pas vdekjes së Skënderbeut), do të jenë edhe fiset pellazge nga Veriu (Etruskët, Venetët dhe të tjerët), si pjesë e shtresimit parahistorik paneuropian, të cilët po ashtu do të përfshihen në themelimin e Romës dhe gjithë atë zhvillim prej nga do të dalë Perandoria Romake. Burimet e shumta historike, nga ato të autorëve antikë dhe të mëvonshmeve, jo vetëm që nuk mohojnë praninë e fiseve të rëndësishme ilire në Italinë e Veriut dhe atë të mesme, por atyre u jepet një vend i rëndësishëm në gjithë kompleksitetin pararomak dhe atë romak pa përjashtuar këtu edhe ndikimin e tyre deri te formësimi i gjuhës latine që shihet drejtpërdrejt e lidhur me gjuhën e Ilirëve.<sup>250</sup>

Kjo vlen veçmas për Etruskët, prania e të cilëve njihet në këto anë nga shekulli VIII para erës sonë e këndeje. Siç u pa, edhe sot mbishkrimet etruske si dhe

---

<sup>250</sup> Geza, Alföldy: “Die römische Gesellschaft-Struktur und Eigenart”, 1975.

gjurmët e tjera të qytetërimit të tyre, paraqesin një enigmë të madhe, që vetëm shqipja mban çelësin për zbërthimin e të vërtetës rreth rolit të madh të pasardhësve të Pellazgëve që do të luajnë te qytetërimi helen dhe ai romak.

Kur këtij faktori - që është shumë i rëndësishëm për të treguar se për Ilirët, Dardanët, Maqedonasit si pasardhës të Pellazgëve të moçëm - themel i shtresimit të parë indoeuropian në kontinentin e vjetër dhe më gjerë, Perandoria Romake nuk ishte as e panjohur e as huaj, por ishte edhe pjesë e një të kaluarë të tyre - i shtohet edhe ai se edhe pas pushtimit nga Roma Ilirët dhe Dardanët nën ombrellën e Perandorisë Romake hynë me strukturat e tyre të brendshme shoqërore nga ato fisnore e deri te ato të dinastive skllavopronare, të cilat u pranuan dhe u përligjën në kuadër të riorganizimit të ri perandorak dhe administrativ me autonomitë vetëqeverisëse dhe format e tjera të ruajtjes së identitetit etnik, atëherë del më se e qartë pse romanizimi si aspekt kulturor në përputhje me preformansën e një trashëgimie të hershme të përbashkët e bartur nëpërmes gjuhës së shkruar, siç ishte latinishtja zyrtare, dhe duke u ruajtur etnia dhe tërësia e saj, shërbeu si një mjet i përshtatshëm që Ilirët dhe Dardanët t'ia dalin që të ngrihen aq shpejt në hierarkinë politike, ushtarake dhe ekonomike të Perandorisë Romake deri aty sa për te të luftojnë deri në pikën e fundit.

Edhe jashtë këtij kundrimi historik, i cili është shumë i rëndësishëm për t'u parë disa të vërteta të anashkaluara ose të harruara të të përbashkëtave nga lash-tësiamidis Ilirëve, Dardanëve dhe Romës, që kanë përcaktuar edhe qëndrimin e tyre ndaj Perandorisë Romake, por edhe të Romakëve ndaj atyre, pra po që se u kthehemi realiteteve të reja të krijuara pas luftërave të gjata ilire-romake, të cilat do të përfundojnë me pushtimin e viseve ilire dhe dardane në pjesën tjetër të Adriatikut dhe në pjesën Qendrore, lufta dhe pushtime këto që ruajnë preformansën e luftërave të përhershme për pushtet brenda mbretërive simotra (dardane, maqedonase, epirote, ilire), ka qenë interesi i tyre që në rrethanat e reja të përfitojnë sa më shumë dhe se kjo ka qenë e mundur vetëm me përfshirjen në kuadër të një sistemi të avancuar shoqëror, administrativ, ekonomik, politik dhe kulturor çfarë në të vërtetë ishte ai romak. Mund të thuhet se koncepti romak i "*paxromana*", i cili ka krijuar një mundësi që brenda tij të veprohet dhe të përfitohet, veçmas në planin ekonomik, ushtarak dhe atë kulturor, nuk ka qenë vetëm formulë e përshtatshme politike, por ka paraqitur edhe frymën e një koncepti, i cili është mbështetur edhe në rrënjën e përbashkët që nga antikiteti, sado që kjo mbetet çështje hipotetike, më shumë filozofike se sa historike. Por, nëse midis fantazisë së Virgjilit për mallin e Eneut për Trojën që do të derdhet në Romë dhe përkushtimit të

Konstandinit të Madh që qendrën e perandorisë ta bartë në Lindje do të kalojnë njëzet shekuj, megjithatë kemi një veprim që historinë e kthen në të njëjtën pikë, atëherë nuk ka pse të anashkalohej e dhëna se në skenën e saj ishin të njëjtat aktorë (Ilirët dhe Dardanët) pasardhës të Pellazgëve antikë, prej nga e kanë rrënjën edhe Romakët, që kanë të drejtë të sillen në përputhje me këtë vetëdije historike.

Nëse çështjes që shtrohet, i merren që të gjitha reminishencat historike dhe letrare, atëherë edhe pa to, mund të thuhet se meqë hapësira e Ilirikut si njësi etno-administrative, ku sipas konceptit romak përfshihej edhe Dardania si provincë e veçantë, ishte njëra ndër më të mëdhatë dhe më të rëndësishme nga pikëpamja strategjike, por edhe ekonomike, romanizimin si aspekt shoqëror dhe politik e kishte të pashmangshëm, ngaqë nëpër të kalonin rrugët kryesore që lidhnin Perëndimin me Lindjen si dhe Europën Qendrore me atë jugore dhe Veriore njëherësh. Andaj, ishte e natyrshme që nga rihapja e rrugëve antike, nga qarkullimi i mallrave, i njerëzve dhe i ideve në anë të ndryshme, të përfitonte popullata e saj, veçmas kur dihej se ajo gëzonte të drejtën që të ndalte një pjesë të taksave doganore dhe të ardhurave të tjera për nevojat e veta. Nëse kësaj i shtohet edhe faktori ushtarak dhe rëndësinë që paraqiste ai drejt përfshirjes së të rinjve të kësaj ane në strukturat e saj, ku nuk do të vonojë dhe ata do të fitojnë mundësitë për t'u ngritur në hierarkinë më të lartë ushtarake dhe me këtë për të përfituar një tretman të lartë qytetarie romake ndër më të privilegjuarat prej nga ata do të fitojnë mundësinë të kthehen edhe në perandorë, siç do të ndodhë me shumë sish, atëherë është më se e qartë se këto rrethana nënkuptonin shkallë të lartë të integritit shoqëror, ekonomik, politik që nënkuptonte edhe atë kulturor. Ky integrim ngrihej mbi platformën e një sistemi të vlerave të njohura në të cilin do të participojnë edhe Ilirët, Dardanët, Maqedonasit bashkë me të tjerët për të ardhur deri te shkalla e një vetëdije se ashtu mbronin vendin e tyre, një perandori që në fazën e fundit quhej edhe romake-ilire, e cila udhëhiqej nga perandorë ilirë dhe dardanë, siç do të ndodhë, pak më vonë edhe me Bizantin kur do të quhet "Bizanti Ilir".<sup>251</sup>

Romanizimi i një pjese të Ilirëve, Dardanëve, Maqedonasve, Trakasve dhe popullatave të tjera të pushtuara ose të përfshira në përbërje të Perandorisë Romake, ka ekzistuar në një shkallë të konsiderueshme dhe madje ka qenë edhe një fenomen i natyrshëm, meqë, siç u pa, lidhej me vetë natyrën e Perandorisë si një

---

<sup>251</sup> Më gjerësisht shih: Budimir, Milan: "O etničkom odnosu dardanaca prema ilirima", Beograd, 1950; "Grci i Pelsci", Beograd, 1951.

koncept kozmopolit që mbështetej mbi parimet e njohura të qytetarisë romake, me latinishten si gjuhë zyrtare dhe kulture, ku popujt e shumtë, të përfshirë në të fitojnë mundësinë që t'i realizojnë të drejtat e tyre si qytetarë të rëndomtë, me ç'rast “*paxromana*” i shpallur me dekretin e perandorit Karakalla në vitin 212 pas erës sonë, praktikisht do të kthehet në një nxitës të mëtutjeshëm të paqes së brendshme edhe për faktin se krahas vetëqeverisjes së plotë, bashkësitë fisnore si dhe ato të latifondeve fitojnë të drejtën që, në saje të prodhimit në bujqësi ashtu edhe në xehetari, të kthehen në një bosht të rëndësishëm ekonomik. Pra, “*paxromana*”, ka kushtëzuar forcimin e mëtutjeshëm të provincave dhe njëherësh ka qenë edhe faktor politik, që ka ndikuar në hierarkinë e pushtetit perandorak nga qendra te provincat, pra nga senati te ushtria, gjendje kjo që ka mundur të forcohet vetëm me vetëqeverisje politike dhe ekonomike nga baza, ku faktori autokton, në rastin konkret ai Ilir dhe dardan, ka fituar gjithnjë e më shumë në peshë dhe hapësirë për të ardhur deri te pika sa edhe të kthehet në faktor vendimtar.

Të dhënat e kohës, veçmas ato që vijnë nga antika e vonshme, tregojnë se ekonomia jo vetëm që kishte ruajtur elementin autokton, por atë e kishte forcuar edhe më tepër, meqë *fshatarët e lirë (in colae)*, dhe shtresat e tjera të ngjashme, gjatë sundimit të Valencianit, Gracianit dhe Valensit përmenden si faktorë tejet të rëndësishëm ekonomikë, të cilët i kishin ndihmuar vendit, që të ruajë stabilitetin kur në disa pjesë ishte rrezikuar.<sup>252</sup>

Këta dhe shembujt e ngjashëm mjaftojnë të hedhin më shumë dritë në çështjen e romanizimit dhe natyrën e tij të veçantë gjatë kohës së Perandorisë Romake si një zhvillim i cili ka nënkuptuar përfshirjen e të gjithë shtetasve të saj në një sistem të përbashkët administrativ, shoqëror, juridik dhe kulturor, por jo edhe shkrirjen e domosdoshme dhe të plotë të entiteteve autoktone, siç qenë Ilirët, Dardanët dhe të tjerët në pjesën lindore të saj nga se diçka e tillë nuk ishte në interesin e saj, veçmas kur dihej se do të jetë pikërisht popullata autoktone në këto pjesë që do të mbrojtë më së miri perandorinë nga kërcënimet e barbarëve që vinin nga Veriu e Lindja. Këtë mund ta bënin më së miri po qe se nga pikëpamja shoqërore, politike dhe ekonomike ndjeheshin të lidhur për të, si të tyre dhe në përputhje me interesat e tyre. Këtu ka bazën edhe strategjia e njohur e mbrojtjes (*securitatis populi romani*), e cila mbështetej në organizimin administrativ mbi vetëqeverisjen e gjerë të shumë krahinave nga nivelet më të larta deri në rrafshet lokale, ku përfshi-

---

<sup>252</sup> Mirdita, Zef: “*Studime dardane*”, Prishtinë, 1979, faqe 128.

heshin kështjellat dhe qytetet e pavarura (“*castella*” dhe “*optidave*”), të cilat si lokalitete me karakter ekonomik dhe të depove të ndryshme, njëherësh kanë shërbyer si pikë mbrojtje.<sup>253</sup>

Vendbanime të tilla të pavarura, ka pasur shumë edhe në Dardani dhe ato kanë qenë në pikat qendrore dhe strategjike të komunikacionit, ku praktikisht nuk ka pasur mundësi për një romanizim intensiv, sado që nuk duhet përjashtuar atë të natyrshmin, në të cilin është përfshirë shtresa elite e popullatës dhe ajo që për arsye ekonomike ose të tregtisë në kuadër të normave shtetërore, administrative dhe standardet shoqërore të Perandorisë, si pjesë e sistemit të përbashkët të vlerave prej të cilave ka pasur përfitime. Por, edhe ajo që mund të quhet romanizim i natyrshëm, në Dardani thuhet se u ngri, pra ngeci, pas reformave ushtarake të Dioklecianit në mbarim të shekullit III pas erës sonë, meqë në këtë kohë ushtria jo vetëm që nuk flet, por as që di të flasë latinisht.<sup>254</sup>

Në këtë proces gjithsesi duhet bërë dallim midis romanizimit shoqëror dhe atij shpirtëror, nga ai politik te ai i vetëdijes, sado që ato edhe mund të shkojnë bashkë, ku i pari ndihmon të dytin, ndërsa i dyti ia përcakton pastaj karakterin.

Në të vërtetë, duhet pranuar se nga shekulli I i erës sonë, me pushtimin e plotë të Ilirisë dhe të Dardanisë dhe të pjesëve të tjera përreth, nisi të përhapej edhe kultura romake, por duke u ndërthurur edhe me etnokulturën, veçmas me ato forma, të cilat mund të ktheheshin në vlera të përbashkëta. Në këtë proces, do të ketë edhe një zhvillim pozitiv, meqë ndërthurja me kulturën vendore, do të shuajë ndryshimet kulturore që ishin deri më atëherë midis krahinave lire dhe vetë Ilirëve e dardanëve ngase familja e madhe ilire, por edhe Dardanët, nga pikëpamja politike nuk kishin ndonjë lidhje të brendshme të përhershme. Kështu, pra, vatrat kryesore të përhapjes së kulturës romake, të cilën duhet parë edhe si kulturë kozmopolite, u bënë kolonitë e *municipet*, pra në ato qytete, të cilat u bënë qendra të rëndësishme ekonomike dhe ishte e natyrshme që të kenë edhe një jetë të gjallë kulturore, e cila zhvillohej nëpërmjet një gjuhë të përbashkët komunikimi – zyrtare dhe kishtarë, siç ishte latinishtja.<sup>255</sup>

Para se të fillojë sistemi i *municipiave*, pra i vendosjes së kolonive, që i kanë shërbyer infrastrukturës së re administrative dhe ekonomike të perandorisë, duhet

---

<sup>253</sup> Evans, I.A: “*Antiquarian rerearsches ub Illyricum*”, faqe 167.dhe Rostovtzeff, I.M: “*The social and economic histori of the Roman Impire*”, I, Oxford 1957, faqe 243.

<sup>254</sup> Shih: Eusebius: “*Vita Constantini*”, IV/19.

<sup>255</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i parë, Tiranë, 2002, faqe 177

theksuar se romakët i kanë kushtuar rëndësi përvetësimit të shtresave aristokrate me anën e dhënies së të drejtës romake organit vetëqeverisës të bashkësive dardane të njohur si “*civitates*”, në krye të të cilave gjendej kryeplaku apo “*princeps*” i popullatës vendore.<sup>256</sup>

Ruajtja e bashkësive vendore “*civitates*” si dhe statusi i tyre vetëqeverisës dëshmon politikën e kompromiseve të Romës ndaj interesave të caktuara të popullatës vendore, me çka dëshmohet pse romanizimi në pjesët e shumta të Dardanisë dhe në vise të caktuara në Ilirik, nuk ka mundur të jetë intensiv, ku është ruajtur organizimi i jetës autonome.<sup>257</sup> Kjo dëshmohet edhe me ruajtjen e elementeve të kulturës autoktone, siç janë materialet epigrafike me emra të popullatës vendore (dardane dhe ilire) dhe elementet karakteristike etnografike, siç është marama, gjerdani i madh me medaljon dhe të tjera të gjetura në pjesë të ndryshme të Dardanisë.<sup>258</sup>

Por, romanizimi i pjesshëm ose i pahetueshëm në pjesët jashtë komunikimeve dhe qendrave administrative, nuk ka kursyer pjesët urbane. Kjo ishte edhe e natyrshme kur kihën parasysh faktorët ekonomik, politik dhe ata ushtarak që përcaktuan karakterin e perandorisë së re. Në këto ambiente të reja urbane, krahas urbanizimit të ri, Romakët sollën edhe institucionet kulturore, nga teatri i vogël dhe i mbuluar (odeon), biblioteka e deri te muzetë e ndryshëm. Po ashtu, nëpër disa qytete, u ndërtuan edhe amfiteatro të mëdha me arena, ku zhvilloheshin gara sportive, por edhe veprimtari kulturore.

Meqë disa nga qytetet bregdetare, qoftë si koloni apo si qendra të njohura tregtare që kishin gëzuar autonomi (Butrinti, Apolonia, Durrësi dhe të tjera) kishin objekte publike kulturore (amfiteatrot e mëdhenj, teatrot dhe bibliotekat), ato do të zgjerohen ose do t’u shtohen të tjera, siç kishte ndodhur edhe me amfiteatrin e Dyrrahut dhe atë të Apolonisë, kur afër tyre ishin ndërtuar të tjerët, por shumë më të mëdhenj dhe në përputhje me kërkesat e reja.

Në tre shekujt e parë të erës sonë një zhvillim të ndjeshëm ka pasur edhe arti plastik, sidomos skulptura. Në rrënojat e Apolonisë, në Durrëh, Butrint dhe qytete të tjera bregdetare janë zbuluar skulptura sipas artit helenistik, por edhe ato të artit romak. Skulptura të ngjashme ndeshim edhe në pjesët e Dardanisë, në lokalitetin e Ulpianës, të Justiniana Primës, Naissusit, Scubit dhe pjesëve të tjera. Në

---

<sup>256</sup> Shih: Dujje Rendić – Miočević: „*Problemi romanizacije Ilira*”, te „II Simpozijum o Ilirima u antička doba”, Sarajevo, 1966. Posebna izdanja Centra za balkanološka ispitivanja, knjiga 2, Sarajevo, 1967, faqe, 167.

<sup>257</sup> Shih: Rostovtzeff, I. M: “*The social and ekonomik histori of the Roman Empire*”, I, 2, Oxford, 1957, faqe 243.

<sup>258</sup> Shih: Čerškov, E: “*Antička bista žene iz Klokota*” në Glasnik Muzeja Kosova i Metohije III/1958, faqe 192.

plastikën e vogël vendin kryesor e zënë figurat prej bronzit, të prodhuara të shumtën në seri, të cilat lidhen me hyjni dhe me personazhe laike.<sup>259</sup>

Një përhapje të gjerë ka pasur edhe arti i mozaikut. Edhe mozaikët dhe zhvillimi i tyre, ashtu sikur veprat më të bukura të arkitekturës dhe të skulpturës, kanë qenë të lidhura me shtresat e larta të provincave, si të atyre të qyteteve, ashtu edhe të vendbanimeve fshatare, të zotëruesve të vilave e latifondistëve.<sup>260</sup>

Të kësaj natyre janë disa nga mozaikët monumental në Vendenis, në afërsi të Podujevës, të zbuluara para pak kohësh. Por, mozaikë të ngjashëm ndeshim edhe në Therandë dhe Ulpianë, shumica syresh me motive të marra nga mitologjia e lashtë.

Për ndryshim nga pjesët e tjera të Perandorisë, ku vërehet një rënie e qendrave urbane, në shekujt e tretë dhe të katërt pas erës sonë, kultura urbane në Dardani do të ketë një ngritje të dukshme ndër më të shënueshmet. Kjo më pak ka të bëjë me atë pse perandorët e kësaj kohe të shumtën vinin nga kjo pjesë dhe nga kasta ushtarake e cila kishte filluar të ketë fjalën kryesore në nivelet më të larta. Më shumë ka të bëjë me reformat politike dhe administrative që do të ndërmerren që Perandorisë t'i sigurohet ekzistenca aty ku rrezikohej më së shumti nga sulmet barbare, pra në pjesët strategjike siç ishin ato të Ilirikut dhe të Dardanisë. Ky komponent, natyrisht se ka pasur edhe rrjedhat pozitive, sepse krahas forcimit të klasës politike nga provinca (kryesisht ushtarake, me prejardhje vendore) dhe ndikimit të saj në hierarkinë perandorake, që është pasqyruar me bartjen e piramidës së forcës së saj nga kryeqendra në periferi, po ashtu ka ndikuar në ngritjen dhe zhvillimin e qendrave urbane nga fortifikatat (*castellat*) deri te qytetet (*oppida*), të cilat janë kthyer në faktorë të rëndësishëm politikë dhe ekonomikë.

Bie në sy se nga kjo pikëpamje Dardania thuhet se ka përfituruar më së shumti, veçmas nga gjysma e dytë e shekullit të dytë deri te i gjashti pas erës sonë. Të dhënat e kohës flasin për atë se si në këto pjesë do të ringjallen shumë nga vendbanimet e dikurshme, ndërkohë që do t'u shtohen edhe të tjera. Natyrisht se do të jetë aspekti strategjik (mundësia e mbrojtjes nga sulmet barbare) që ka luajtur rol në këtë zhvillim, gjë që diku-diku është parë edhe si faktori kryesor. Por, me këtë rast, nuk duhet harruar se Dardania si dhe pjesët e Ilirikut përreth,

---

<sup>259</sup> Shih: Mirdita, Zef: “*Studuime dardane*”, Prishtinë, 1979; Shukriu, Edi: “*Ancient Kosova*”, Prishtinë 2004; Mikulčić, Ivan: “*Teritoria Skupa*”, në ZA.XX/2 1971; Barišić, Franjo: “*Današnji pokušaji ubikacije grada Justiniana Prima*”, Zbornik Filozofskog Fakulteta, Beograd, VII-1963.

<sup>260</sup> Dobruna – Salihu: “*Plastika dekorative dhe figurave dhe e stelave mbivarrore t periudhës romake në Kosovë*”, Gjurmime Albanologjike 14/1985; Shukriu, Edi: “*Ancient Kosova*”, Prishtinë, 2004.



kanë qenë të populluara thuajse mbi mesataren e viseve të tjera, dhe po ashtu, në këto pjesë ka pasur qendra të rëndësishme urbane, qoftë pse në Dardani kanë qenë pjesa më e madhe e xeheroreve të metaleve, ku është zhvilluar edhe përpunimi i tyre, qoftë pse nëpër këtë vend, nëpër rrjedhat e lumenjve (Vardarit në drejtim të Egjeut, Ibrit dhe Moravës në drejtim të Danubit dhe Detit të Zi, Drinit të Bardhë në drejtim të Adriatikut), por edhe të rrugëve të vjetra që kanë lidhur Perëndimin me Lindjen.<sup>261</sup>

Mjafton të përmenden të dhënat e Ptolemeut i cili në Dardani identifikon qytetet Naissus, bashkë me disa të tjera përreth si qendra të mëdha të nxjerrjes dhe të përpunimit të metaleve, por edhe për qytete të rëndësishme në këto pjesë (Scubi, Shkupi i sotëm, Ulpiana, Theranda e të tjera) për të cilat flasin edhe autorë të tjerë antikë, të cilave gjatë kohës romake do t'u shtohen edhe shumë e shumë të tjera, si Justiniana Prima, Justiniana Sekonda e të tjera.<sup>262</sup>

Bëhet e ditur se perandori Justinian I (527-556), që vinte nga Taurusi i Dardanisë, në këto pjesë ndërtoi dhe rindërtoi 94 kështjella.<sup>263</sup> Por, krahas kështjellave të shumta, perandori Justinian I, në afërsi të qytetit të lindjes, pranë fortesës Bederiana, të rrethuar me një mur në formë katrori me katër kulla tetrapyrge, ndërtoi një qytet madhështor që e quajti Justiniana Prima.<sup>264</sup>

Perandori këtu ndërtoi edhe një ujësjellës madhështor, që të kishte ujë në të gjitha stinët. Prokopi i Cezaresë shkruan se si perandori kishte stolisur qytetin me tempuj, galeri, sheshe publike, pallate, banja dhe dyqanet.<sup>265</sup> Më tutje Prokopi

---

<sup>261</sup> Papazoglu, Fanula: "Dardanska onomastika" në Zbornik Filozofskog Fakulteta, Beograd, VIII-1, 1964 dhe "Makedonski gradovi u rimska doba", Skopje, 1957.

<sup>262</sup> Ptolemei, Claudii: "Geographia", I-IV, Geographike Buch, Leipzig, 1843.

<sup>263</sup> Patsch, Carl: "Dardani", në: Paulus Realencyklopedi der classischen Altertumswissenschaft, IV/1901 dhe "Historia e Popullit Shqiptar", vëllimi i parë, Tiranë, 2002, faqe 179.

<sup>264</sup> Prokopii Caesarensis (Prokopi i Cezaresë), historian i madh bizantin i kohës së Justinianit. Lindi në Cezare të Palestinës aty nga fundi i shek. V dhe fillimi i shek. VI të erës sonë. Pasi kreu studimet në shkollën e sofistëve në Gata, u vendos në Konstantinopol dhe zuri vend me rëndësi në administratën e Bizantitë. Prokopi shkroi tri vepra: "De Bellis" (Historia e luftimeve), "De aedificiis" (Mbi ndërtimet) dhe "Historia arcana" (Historia e fshehtë). Në traktatin "Mbi ndërtimet" gjejmë shënime mbi ndërtimet që bëri Justiniani në gjithë Perandorinë, ku me interes janë ato që bëhet fjalë mbi gjeografinë dhe toponomastikën e Ilirisë dhe të Dardanisë. Kështu, në listën e gjatë të kështjellave të ndërtuara ose të rindërtuara nga Justiniani, që na jep Prokopi, përmbahen edhe shumë emra qytetesh dhe lokalitetesh të Ilirisë dhe Dardanisë. Ndër to jipen emrat e këtyre tetë kështjellave të reja: Laberion, Kastimon, Rabeston, Akrenza, Terios, Drullon dhe Viktorias. Ndër kështjellat e rindërtuara përmenden këto: Kesiana, Tezule, Usiana, Maskas, Liste, Keliriana, Zysbaes, Genzana, Petrizen, Euttyhia, Mulato, Belas, Kataros, Katareos, Pentza, Katafeteros, Dabanos, Kubinos, Germatza, Viktoriana, Azeta, Durbulina, Surikon, Kusines, Tutiana, Balesiana, Bella, Kaltrelates, Kasyella, Maniana, Priskupera, Mitetes, Dardapara, Kesuna, Beriniana, Lasbaros, Kastellobretara, Edetzio, Dinion, Kekola, Emastos, Kastelona, Kapamolba, Seretos, Ptoheion, Kuino, Berzana, Arsa, Bleza, Labutza, Kuintu, Bermezion, Rotun, Kobenkiles, Markeliana, Primoniana, Pamilinos dhe Aria (Shih: "De aedificiis", libri IV/4).

<sup>265</sup> Po aty, Libri IV/17-26.

njofton se si ai e bëri këtë një qytet të madh, shumë popullor dhe të pasur, në mënyrë të tillë që ai jo vetëm u ngrit në dinjitetin e metropolit, por u zgjodh edhe si qendër e kryepeshkopit të Ilirëve, meqenëse qytetet e tjera ia lanë këtë nder si qytetit më të madh të vendit.<sup>266</sup>

Krahas ndërtimit të Justiana Primës dhe ngritjes së saj në një qytet madhështor, Prokopi i Cezaresë, jep të dhëna tepër të rëndësishme edhe për rindërtimet e qendrave të vjetra, siç ishte Ulpiana, të cilat për arsye të ndryshme sikur kishin humbur rëndësinë e dikurshme.

“Ka pasur në Dardani, që prej kohëve të lashta, një qytet që quhej Ulpiana. Muret e këtij (që ishin duke rënë) ai i rindërtoi që të gjitha. Dhe pasi e stolis me madhështi dhe i dha bukurinë e sotme, i vuri emrin Justiniana Sekonda.”<sup>267</sup>

Me këtë rast bëhet e ditur edhe për themelimin e një qyteti fqinj me emrin Justinopol, me emrin e ungjijt të tij. Por, me interes është edhe përmendja e katër qendrave të rëndësishme të Dardanisë, që do t’u rindërtohen muret: *Sardikës*, *Naispolisit*, *Germanës* dhe *Pantalisë* ndërmjet të cilave themeloi edhe tre qytete të tjera: *Kratiskarën*, *Muimedabën* dhe *Rumisianën*.<sup>268</sup>

Justiniani I ka merita të mëdha se gjatë kohës së tij, pasi që kryepeshkopatën e kishës së Dardanisë do ta sjellë nga Thesaloniki në Justiniana Prima dhe atë do ta kthejë në vikariat të Ilirikut të lidhur drejtpërdrejt me Selinë e Shenjtë, filloi ndërtimin e shumë kishave nga pjesa e Naissusit e deri në Astibo. Thujse të gjitha qendrat e Dardanisë fitojnë kishat e tyre, ndërsa qytetet katedralet. Këtyre objekteve do t’u shtohen edhe lulishtet, pronat dhe hapësirat e tjera në mënyrë që ato të jenë sa më të pasura dhe të hapura për qytetarët.

Përmendja e Justiniana Prima madhështore, ndonëse e ndërlidhur me Justinianin I dhe kohën e tij, e cila i takon Bizantit, gjithsesi nxjerr në pah identitetin etnik dardan në zgjerim e sipër edhe në rrethanat e Perandorisë Romake, që do të bartet në realitetet e Bizantit, ku vazhdon rëndësia e Dardanisë si provincë, e cila nga shekulli IV shfaqet më vete. Andaj, si e tillë, Justiniana Prima, krahas rolit që pati për të ardhmen (shekujt V-VI si qendër kishtarë), ajo më shumë shpjegon zhvillimin kulturor dhe politik të Dardanisë gjatë shekujve paraprakë, pra nga koha e reformave të Dioklecianit si dhe atyre të Kostandinit të Madh, kur Dardania praktikisht kthehet në një “qendër kalimtare” prej nga pushteti i Romës do të bartet në Bizant, rëndësia e së cilës është anashkaluar

---

<sup>266</sup> Po aty, libri IV/27.

<sup>267</sup> Po aty, libri IV/30.

<sup>268</sup> Po aty, libri IV/33.

sepse aty është parë metafora e lidhjes me Trojën me çka sërish rishfaqen Pellazgët dhe trashëgimia e tyre si faktor kyç, që përcakton raportet midis Lindjes dhe Perëndimit, por këtë herë me oreolin e krishterimit.

Sidoqoftë, Justiniana Prima, ndonëse e shfaqur në shekullin V në vend të Scupit të lashtë të rrënuar nga tërmeti me pasoja katastrofale të vitit 518<sup>269</sup>, paraqet epiqendrën e forcës që shtrihej nga Naissusi dhe vazhdon tutje në drejtim të Thesolanikit, ku ndërlihen qendrat e tjera të rëndësishme: *Ulpiana*, *Theranda*, *Hersona*, *Bederiana*, *Taurisiumi* e të tjera, forcë kjo që flet për rëndësinë që kishin Dardania në kapërcylin e rëndësishëm të ngjarjeve, që lidhen me Bizantin dhe atë që në histori njihet si Mesjetë.

---

<sup>269</sup> Sipas kronikës së Comes Marcelinit "*Chronicon ad an 518*", në MGF AA, 100, pos të tjerash thuhet se "tërmeti që kishte rënë në Dardani, kishte shkatërruar edhe 24 kastele".



PJESAE DYTË

MESJETA



## KAPITULLI I PARË

### BIZANTI

#### ILIRIKU DHE SHFAQJA E BIZANTIT

Do të jenë dy zhvillime të kthesave historike që sollën deri te dobësimi e pak më vonë te rënia e Perandorisë së Romës si dhe shfaqja e Bizantit, që do të njihet si Perandori Romake e Krishterë.

I pari ka të bëjë me krizën e sistemit skllavopronar, që për pasojë do të ketë krizën e papërballueshme shoqërore dhe politike të Perandorisë.

I dyti ka të bëjë me paraqitjen e sulmeve të barbarëve (fillimisht të Hunëve e Gotëve dhe fiseve të tjera) në pjesët lindore të Perandorisë.

Këto zhvillime megjithatë, nuk do të kishin peshën çfarë në të vërtetë do ta kenë pa faktorin krishterim, i cili filloi të shfaqet në shekullin e parë të erës sonë dhe ndikoi drejtpërdrejt në shfaqjen e Bizantit dhe atë që do njihet si Mesjetë.

Me këtë rast duhet thënë se aktorët kryesorë në arenën e këtij zhvillimi historik, që do të shënojnë kapërcimin nga njëra kohë në tjetrën, qenë pikërisht Ilirët dhe Dardanët dhe viset e tyre në Ilirik, siç kishin qenë shekuj më parë kur Roma po bëhej gati që fuqinë e Perandorisë ta fitonte duke u shtrirë në hapësirën e Ilirikut, të Dardanisë, të Maqedonisë, Greqisë dhe të viseve të tjera këndeje nga Lindja dhe veriu, siç do të jenë edhe popujt barbarë (Gotët, Hunët, Sllavët e të tjerë) nga Lindja, të cilët do të ngrihen mbi hapësirën ilire dhe dardane për ta kthyer atë në pjesë të realiteteve të tjera etnike, kulturore dhe shtetëror.

Megjithatë, Ilirët, Dardanët, Maqedonasit dhe të tjerët, në një ndeshje të ashpër me pushtuesit barbarë, nga mesjeta e këndeje, në kuadër të Perandorisë së përbashkët, ndonëse e udhëhequr nga koncepti i qytetarisë romake të universalizmit të qytetarisë (*civis romanes*) dhe asaj bizantine (*romaios*), shfaqen edhe me identitet të caktuar *vetëqeverisës, administrativ* dhe *fetar*, në kuadër të strukturës së gjithëmbarshme të ngrehinës shtetërore perandorake.

Para se të ndodhë te ky ndryshim i madh i përkufizuar kohësisht si Mesjetë dhe si Bizant, prej nga iliro-Dardanët nga shekulli X pas erës sonë e këndeje do të

shihen si *Albanë, Arvanitë, Albani, Arbanasi, Rabani* dhe ndryshe, ndërsa hapësira e tyre si *Alabani, Albaniae, Albanone* ndryshe në përputhje me gjuhët e ndryshme, që do të zgjasë edhe për një mijë vjet, duhet parë pikërisht rrethanat që i paraprinë atij, pra që sollën deri te ai.

Edhe këtu fjalën kryesore edhe në kuadër të konceptit të universalizmit të qytetarisë do ta kenë perandorët Romakë me prejardhje ilire-dardane si dhe vetë Iliriku si provincë kyçe e Perandorisë mbi të cilën do të ushtrohen përpjekjet kryesore që do ta ndikojnë por edhe do ta përshpejtojnë këtë zhvillim historik. Kështu, do të jetë perandori Dioklecian (284-305 pas erës sonë) me prejardhje ilire, ai që do të fillojë reformat më të thella dhe gjithëpërfshirëse deri më atëherë, me anën e të cilave Iliriku do t'i përcaktohet një rol i rëndësishëm në rivitalizimin ekonomik dhe politik të Perandorisë. Kjo rrugë do të vazhdohet nga perandori tjetër, Dardani Konstatini i Madh (306-337 pas erës sonë), në reformat e të cilit Iliriku si gjithë pjesa lindore e Perandorisë, do të mbetet në Lindje, pra në Bizant.

Duke menduar se kriza perandorake mund të zgjidhej me anën e reformave administrative, pra që pushteti qendror të zhvendosej përfundimisht te ai provincial, ku kishte mbështetje klasa ushtarake, e cila aty e kishte epiqendrën e vet që mbahej, si dihet, Diokleciani e ndau pushtetin perandorak në fillim midis dy, pastaj midis katër bashkësundimtarësh, të gjithë me origjinë ilire-dardane. Me këtë masë, në fundin e shekullit IV, praktikisht shënohej fillimi i ndarjes së Perandorisë në dy pjesë. Pjesa lindore formohej nga dy prefektura të mëdha: të Lindjes dhe e Ilirikut. Qendër e kësaj të fundit ishte Sirmium (Mitrovica e Sremit). Më tutje, prefektura e Ilirikut ndahej në 3 dioqeza, që përfshinin disa njësi administrative edhe më të vogla, provincat. Në të parën hynin krahinat e Dalmacisë së jugut dhe të Ilirisë së veriut me qendër Shkodrën (Prevalia), provinca e Epirit të Ri (Epirus Nova) nga Durrahu deri te Epiri i Vjetër (Epirus Vetus) si dhe tokat në jug të Vjosës me qendër Nikopolis (Nikopojën).<sup>270</sup>

Pas kësaj mase, e cila edhe për pak kohë do t'ia shtyjë jetën regjimit skllavopronar, por nuk do ta shpëtojë nga dështimi përfundimtar që do të marrë fund me shthurjen e tij, Konstantini i Madh, ishte i vetëdijshëm se Perandoria do të përballet me një krizë tjetër të brendshme edhe më të madhe shoqërore dhe politike nga shkaku i vetëm se lirimi nga skllavëria kërkonte një dividendë të caktuar shoqërore, të cilën e kërkonte shtresa e lirë, kështu që ai pranoi krishterimin si një mjet të mirë me të cilin mund ta mbikëqyrte masën, por njëherësh ta

---

<sup>270</sup> Më gjerësisht shih: Ostrogorski, Georg: "Historia e Perandorisë Bizantine", Tiranë, 2002; Faverial, Zhan Klod: "Historia (më e vjetër) e Shqipërisë", Tiranë 2004, faqe 73.



forconte edhe pushtetin absolut perandorak me anën e fuqisë së kishës, që do ta kthejë në aleat të vetin.

Perandori “me fuqinë e zotit dhe bekimin e tij” dhe kisha e fuqizuar me bekimin e perandorit, krijonin binomin e ri të fuqisë thujse të paprekshme, që do të ndryshojë kahun shoqëror dhe politik të Perandorisë, por edhe të qytetërimit në përgjithësi. Këtij akti historik, ndër më të rëndësishmit e kohës, i priu nxjerrja e urdhëresës së famshme për ndalimin e përndjekjeve të të krishterëve (viti 311 i erës sonë), e cila dy vjet më pas u shoqërua me urdhëresën tjetër për përkrahjen e krishterimit, me çka mund të thuhet se krishterimi u pranua si besim zyrtar i Perandorisë, që si do të shihet, do të bëhet edhe bashkëpjesëmarrës në qeverisjen shtetërore, ku *universin romak* do ta zëvendësojë *universi i krishterë*, edhe pse një aspiratë e tillë do të pësonte vazhdimisht zhgënjime përballë realitetit politik.

Që ta kodifikojë këtë vendim historik, më 325 perandori Konstantin i Madh thirri Këshillin e Krishterë të Nikesë ose Koncilin e Nikesë, ku morën pjesë 318 peshkopë nga gjithë Perandoria. Qenia e krishterimit në Ilirik dhe Dardani dëshmohej nga 13 nënshkrime të peshkopëve të pranishëm në Nike, ndër të cilët ishte peshkopi Dacus i Scupit (Shkupi i sotëm) i nënshkruar në dokumentet e koncilin “*Dacus Dardaniae*” dhe Budius i Stobit në Maqedoni dhe i Korkyrës (Korfuzit).<sup>271</sup>

Pas zyrtarizimit të krishterimit, perandori Konstantin i Madh, në vitin 326 shpalli largimin e përgjithmonshëm nga Roma për në Kostandinopojë, me ç’rast katër vjet më vonë shpërnguli edhe selinë e Perandorisë nga Roma në Bizant, të cilit në vitin 330 ia dha emrin e vet, me ç’rast u hap një faqe e re në historinë e qytetërimit, ku krishterimi do të bëhet njëri ndër përcaktuesit kryesor të këtij ndryshimi të madh.

Para se të ndiqen veprimet e mëtutjeshme të pasuesve të Konstantinit të Madh, që do të futen në projektin të cilit ai tashmë ia kishte dhënë vulën, dhe kush më shumë e kush më pak do të mbetet në kornizat e një zhvillimi historik dhjetëshekullor, janë të nevojshme disa sqarime rreth Bizantit si një organizëm politik-fetar me strukturë shtetërore romake, kulturë greke dhe besim të krishterë, sintezë kjo që u bë e mundur nga zhvendosja e gravitetit të Perandorisë së Romës në Lindje, shkaktuar nga kriza e shekullit IV që pati si rrjedhojë kryesore krishterimin e Perandorisë Romake dhe themelimin e një kryeqyteti të ri në Bosfor,<sup>272</sup> në vendin e vogël antik Bizant, afër Trojës legjendare, që sigurisht se nuk ishte

---

<sup>271</sup> Edwien, Jacques: “*Shqiptarët*”, Tiranë, 2007, faqe 163; Gjini, Gaser: “*Skoposko-prizrenska biskupija kroz stoljeća*”, Zagreb 1986, faqe 29.

<sup>272</sup> Ostrogorski, Georg: “*Historia e Perandorisë Bizantine*”, Tiranë, 2002, faqe 17.

zgjedhur rastësisht. Kjo jo vetëm që përkujtonte mbretërinë më të mëdha të kohës, e cila para njëzet e sa shekujsh pikërisht aty qëndronte si një urë që lidhte Perëndimin me Lindjen prej nga edhe buronte fuqia e saj botërore, por me këtë veprim, perandori, si dardan që ishte, sikur bënte të ditur se po i kthehej edhe origjinës së familjes së vet mbretërore, kur i fundit, Priami, kishte humbur luftën dhe ishte detyruar që zhvendimin e saj ta bënte diku në Perëndim, pra në Romë.

Edhe përkundër këtyre asociacioneve me të cilat biografët e shumtë të perandorit të fuqishëm merren edhe sot e gjithë ditën e që edhe mund të kenë pasur ndikimin në hapin historik të perandorit Konstantin, në të vërtetë historia bizantine është pikësëpari një periudhë e re e historisë romake dhe shteti bizantin nuk është tjetër veçse një vazhdim i Perandorisë së vjetër romake. Siç dihet termi “*bizantin*” lindi shumë vonë dhe “*Bizantinët*” e vërtetë nuk e njihnin. Ata vazhdonin të quhen “*Romakë*” (*romei*), ndërsa perandorët bizantinë e thërrisnin veten perandorë romakë.<sup>273</sup>

Kjo “vazhdimësi” kishte edhe të ashtuquajturin kapërcim që kapte tre shekujt e fundit të njëres dhe tre shekujt e fillimit të tjetres, që çoi nga Perandoria Romake në atë të Bizantit mesjetar, ku format e jetës së Romës së lashtë shuhën pak nga pak duke u lënë vendin dukurive të reja të qytetërimit bizantin, të cilat do të shfaqen në rrethanat kur shteti del si një organizëm *politik-fetar*, perandori kthehet në kult *politik-fetar*, ndërsa shtetasit skllëvër të perandorit.

Natyrisht se i gjithë ky ndryshim nuk do të ishte i mundur pa një njësim sublim të qytetërimit të lashtë midis organizimit shtetëror romak dhe asaj që shfaqej kulturë greke, të cilat bashkohen në një koncept të ri për jetën dhe shkrihen në krishterim, tek i cili shteti dhe kultura antike shohin mohimin e plotë. Ai që do t’ia hapë rrugën këtij ndryshimi, gjithsesi, është perandori Dioklecian, me luftën që ia shpalli Republikës së Romës. Si dihet Diokleciani, që erdhi në pushtet në kohën e një krize të thellë politike dhe ekonomike të Perandorisë, ishte i detyruar që të ndërmerre diçka për ta përballuar gjendjen e rëndë, kështu që iu kthye reformave rrënjësore. Duke nxjerrë përfundime nga përvoja e zhvillimit të mëparshëm të shtetit romak, riorganizoi në mënyrë sistematike ndryshimet e bëra ndërkohë që bëri një ristrukturim të përgjithshëm të sistemit shtetëror.<sup>274</sup>

Reforma e Dioklecianit u përsos nga Konstantini i Madh dhe lindi kështu një sistem i ri administrativ, që u bë pikënisja e sistemit bizantin.<sup>275</sup>

---

<sup>273</sup> Po aty, faqe 17.

<sup>274</sup> Po aty, faqe 21.

<sup>275</sup> Vogz, J: “*Constantin der Grosse und sein Jahrhundert*”, Berlin, 1960.

Rikonstruimi i administratës së provincave, që e ndërmori Diokleciani, i dha fund pozitës së privilegjuar të Italisë dhe zhduku dallimin, tashmë pa kuptim, midis *provincave senatoriale* e *provincave perandorake të drejtuara nga ushtarakët*. Kjo bëri që Italia, që më parë kishte pozitën e territorit-metropol, të ndahet në provinca e u detyrua të derdhte atributet si çdo provincë e Perandorisë.<sup>276</sup>

Ndarja administrative e vendit në provinca, prefektura, dioqeza dhe njësi të tjera, dobësoi pushtetin qendror, por forcoi pushtetin e perandorit dhe të ushtarakëve mbi të cilët ai mbështetej gjithnjë e më shumë. Kështu, perandori me anën e prefektëve, guvernatorëve mbikëqyrte çdo gjë me çka mund të thuhet se ai u kthye në një absolutist. Si do të shihet, nga kjo hierarki e centralizuar, u krijua një aparat i madh burokratik, i cili ishte efektiv, por edhe i shtrenjtë për shtetin. Megjithatë, ai u mbajti, sepse ishte mjet i rëndësishëm në duart e perandorit për të ushtruar pushtetin nga pozita e sovranit të pakufizuar.

Tipari më i rëndësishëm i sistemit administrativ diokleciono-konstatinian ishte ndarja e qartë e autoritetit ushtarak nga ai civil. Kështu, administrimi civil i një province ishte në duart e qeveritarit të provincës, ai ushtarak ishte në duart e dukës (*dux*), që ushtronte komandën ushtarake mbi një ose shumë provinca.

Megjithatë, në fushën e organizimit ushtarak Diokleciani dhe Konstantini kryen reforma thelbësore. Më parë ushtria ishte kryesisht ushtri kufiri. Kriza e kohës nxori në pah paaftësinë e saj që të përballet me problemet e sigurisë së brendshme dhe ato të jashtme të vendit, veçmas mbrojtjen nga sulmet barbare në pjesë të ndryshme. Diokleciani ndërmori masa që fuqizimi i ushtrisë të bëhet në kufi, por njëherësh ajo të jetë lëvizëse dhe në gjendje gatishmërie për veprime sipas nevojës. Për këtë arsye ai krijoi njësitë e veçanta, të quajtura *exercitum comitatensis*, që pastaj u përpunuan më vonë edhe nga Konstantini, i cili nuk u mbështet më në gardën pretoriane, të njohur për pretendimet e saj të kahershme për të nxjerrë perandorë.<sup>277</sup> Konstantini shkoi edhe më tej për ta reformuar dhe aftësuar ushtrinë duke ndarë trupat lëvizëse (*comitatensis*) nga ato kufitare (*limitanei*), ndarje kjo që u tregua e suksesshme në planin e brendshëm dhe në atë të jashtëm, ngaqë perandorëve ua ktheu sigurinë qeverisëse, ndërsa armiqve (barbarëve) për një kohë të gjatë ua hoqi mundësitë e rrezikimit nga jashtë duke i detyruar që t'u nënshtrohen rregullave të brendshme.

---

<sup>276</sup> Ostrogorski, Georg: "Historia e Perandorisë Bizantine", Tiranë, 2002, faqe 21.

<sup>277</sup> Më gjerësisht shih: Mommsen, T: "Das römische Militärwesen seit Diocletians", Leipzig, 1899; Ensslin, W: „Zum Heermeisteramt des spätrömischen Reichs“, 129.

Krahas faktorit strukturë shtetërore romake, që ishte një parakusht për krijimin e sintezës bizantine dhe, si u pa në saje të reformave të Dioklecianit dhe Konstantinit të Madh mbeti në fundamentin e tij, por si e reformuar dukshëm, ishte edhe krishterimi, si njëri ndër faktorët shumë të rëndësishëm që ndikoi shteti të kthehet në një organizëm *politik-fetar*, ndërkohë që Perandorin ta kthejë në *kult-politiko fetar*.

Edhe këtu, njëra ndër çështjet më të ngritura të historiografisë, është ajo e qëndrimit të perandorit Konstantin ndaj fesë së krishterë. Disa mendojnë se ai ishte indiferent nga pikëpamja fetare dhe se mbështeste krishterimin thjesht për qëllime politike, të cilat në ato rrethana mund t'i shkonin përshtati, siç ndodhi në të vërtetë. Të tjerët i besojnë konvertimit të tij shpirtëror dhe atij ia njohin meritën më të madhe për kthesën që u shënuar në politikën fetare të Perandorisë së cilës i duhej diçka e tillë për ta shtuar dhe ngjizur kohezionin shoqëror dhe shpirtëror në shturje. Rreth njëres a tjetres pikëpamje janë sjellë argumente të shumta dhe në fakt, ka mjaft arsye për të folur për një bashkim të tij me krishterimin si çështje të një emancipimi shoqëror që i duhej asaj për ta forcuar edhe më tepër pushtetin karshi sfidave të tjera me të cilat përballohej nga brenda, siç ka edhe shumë arsye të tjera për të mbrojtur tezën e besnikërisë së tij ndaj traditave të vjetra pagane nga të cilat ai nuk u shkëput përfundimisht siç kërkohet nga ata që e pranonin krishterimin.<sup>278</sup>

Edhe pse krishterimi vazhdon ta trajtojë Konstantinin e Madh si të merituar dhe këtë ta lidh me përcaktimin shpirtëror, megjithatë qëllimet politike ishin përcaktuese për Konstantinin, që të pranojë krishterimin si njërin nga religjionet e Perandorisë Romake, që e bëri në formën e njohur Edikti i Milanos i vitit 313. Ka shumë të dhëna që flasin se ai nuk iu përkushtua krejtësisht krishterimit dhe as që u bë i krishterë në kuptimin që i jepnin kësaj fjale pasardhësit e tij bizantinë, ngaqë nuk ndërpreu çdo marrëdhënie me traditat pagane.<sup>279</sup>

Përkundrazi, perandori i fuqishëm, nuk e ndaloi paganizmin. Kjo duhet të theksohet edhe me këtë rast, meqë kështu qartësohen raportet e njëmendta midis politikës dhe pushtetit, të cilat kanë ndikuar që krishterimi të pranohet dhe të kthehet në një ndihmaçar të pushtetit perandorak. Madje, ai vetë merri pjesë në

---

<sup>278</sup> Në gjithë bibliografinë e gjerë që ekziston lidhur me këtë çështje Georg Ostrogorski (*Historia e Perandorisë Bizantine*) përqëndrohet te këta autorë: Burckhardt, J: "Die Zeit Constantins des Grosse", Botimi dytë i plotë, Stoccardë 1929; Schwartz, E: "Keiser Constantin und die chistliche Kirche"; Zeller, J: "Quelques remarques sur la "vision" de Constatin "likuide"; Lietzman, K: "Der Glaube Konstatins des Grosse", Berlin, 1937; Vogt, J: "Costantin der Grosse und sein Jahrhundert".

<sup>279</sup> Ostrogorski, Georg: "Historia e Perandorisë Bizantine", Tiranë, 2002, faqe 29.

disa nga këto rite, sidomos në ritin e diellit, rit ky karakteristik, që në vendlindjen e tij, në Dardani do të mbahet i gjallë përherë dhe do të vijë deri në kohën tonë, pavarësisht ndikimit të madh që kishte krishterimi dhe më vonë islami në këto anë, duke u munduar që fuqia e tij t'i atribuohet krijuesit (perëndisë).

Pa marrë parasysh sjelljen personale të Konstantinit ndaj krishterimit dhe pavarësisht çfarë bindjesh ruajti, megjithatë, mbetet fakt i pamohueshëm se ai religjionin e ktheu në instrument politik, se e bëri bashkë-qeverisës, gjë që ndikoi që *vizioni universal* i Perandorisë Romake të zëvendësohet me *atë të krishterë*, ku kisha me të madhe ndikoi në politikën, paçka se u shfrytëzua me të madhe nga politika për qëllimet e veta, koncesione këto të ndërsjella, ndër të cilat më i rëndësishmi është ai që perandori me bekimin kishtar fitoi titullin e përfaqësuesit hyjnor në tokë si një armë të fuqishme për ushtrimin e pushtetit absolut.

Shembulli më i qartë dhe historikisht më i rëndësishëm i ndikimit të krishterimit mbi shtetin romak në kohën e Konstantinit është ai i koncilit të Nikesë, më 325, i pari i një vargu koncilesh ekumenike, që i vunë bazën dogmatike e kano-nike të kishës së krishterë.

Siç dihet në këtë koncil në rend të ditës ishte çështja e presbiterit të Aleksandrisë Arie, i cili nuk e pranonte si të pajtueshëm me monoteizmin *barazinë e Atit e të Birit* dhe që në këtë mënyrë mohonte *natyrën hyjnore* të Krishtit. Doktrina *ariane* u dënua nga koncili, që njohu dogmën e *bashkësubstancës së Atit me të Birin*. Në këtë mënyrë ai u bë neni i besimit, që më vonë, pasi të plotësohej me rezolutat e Koncilit të Dytë ekumenik të Kostandinopojës më 381, do të bëhet kredo e kishës së krishterë.<sup>280</sup>

Kështu, lidhja midis shtetit dhe kishës u solli të dyve përfitime të mëdha, por në të njëjtën kohë edhe vështirësi të reja, meqë shumë nga problemet shtetërore njëherësh u bënë edhe kishtarë, siç ndodhi që ato kishtarë të bëhen edhe shtetërore me çka debatet kishtarë u ndërthurën me ato politike dhe u bënë faktor i përhershëm jo vetëm në historinë e kishës, por edhe në atë të shtetit dhe kështu edhe të politikës e me këtë edhe të shoqërisë.

Këto dukuri nxorën krye qysh në kohën e Konstantinit të Madh. Sidomos ajo e *arianizmit*, e cila nuk u zhduk me vendimet e Koncilit të Nikesë, edhe pse dukej se aty i ishte dhënë një përgjigje, që si do të shihet, së paku nga ana formale, por jo edhe esenciale, epilogun përfundimtar do ta marrë në Koncilin e Dytë.

---

<sup>280</sup> Po aty, faqe 29.

Nga Koncili i Parë deri te ai i dyti, pra nga Nikeja deri te Kostandinopoja, do të duhet të kalojë më shumë se gjysmë shekulli grindje dhe mospajtme në të cilat do të përfshihen të bijtë e Konstantinit të Madh - Konstanci, që qeveriste gjysmën lindore dhe u deklarua në përkrahje të arianizmit, që vdiq shumë herët, më 340 dhe, Konstanti, të cilit i kishte takuar pjesa perëndimore, mbështetën doktrinën e Nikesë.

Mospajtimet midis vëllezërve rreth doktrinave kishtare, vazhduan për shumë kohë, përderisa i madhi vdiq në luftën kundër uzurpatorit Magneç (350), i cili pastaj u mund nga Kostanci në një betejë të përgjakshme.<sup>281</sup>

Fitorja e Konstancit solli një rritje të peshës politike të pjesës lindore të Perandorisë. Perandori kishte për synim që të barazonte fuqinë e Kostandinopojës me atë të Romës, gjë që shkonte në dëm të Romës gjysmë-pagane. Me këtë rast ai shpalli arianizmin fe shtetërore (359). Por, fitorja e përkohshme e arianizmit në shtetin romak-bizantin kishte një pasojë tjetër afatgjate, meqë në atë kohë filloi kthimi në krishterim i Gotëve, me ç'rast popujt gjermanikë e njohën krishterimin në variantin e tij arian. Më 343 Ulfila, që përktheu biblën në gotishte, u shugurua peshkop nga ariani Eusebio i Nikomedisë. Kjo do të ketë ndikim të madh në pjesët perëndimore të Perandorisë, veçmas në Ilirik dhe Dardani,<sup>282</sup> ku edhe do të thadrohen dallimet fetare mbi këtë pikëpamje, që do të vazhdojnë të përçajjnë krishterimin nga brenda e me këtë edhe Perandorinë.

Periudha e konflikteve fetare në Perandori, e cila kulmoi me vendimin e Konstancit që ta kthejë arianizmin, u kundërshtua nga perandori Julian Apostatit (361-363), i cili i shpalli luftë fesë së re, pra krishterimit, duke rikthyer paganizmin. Veprimet e Julianit, përfaqësuesit të fundit të dinastisë së Konstantinit të Madh, ishin të një natyre filozofike e më pak politike. Mbështetja te elita intelektuale dhe politike e Romës si dhe Perëndimit në përgjithësi mund të kënaqte lozhat e caktuara, por jo edhe shtresat e gjera, të cilat tashmë, nën ndikimin e krishterimit dhe premtimeve për jetën e përsëritshme për të cilën flitej kudo, u ishin kthyer predikimeve për shpresën që mund ta ofronte vetëm doktrina kishtare e barazisë, e cila ishte joshëse sa edhe dehëse për masat e gjera, të cilat me këtë "eliksir" mund të ktheheshin në instrument të lëvizjeve shoqërore dhe politike pa marrë parasysh kahun, që nuk mund të ishte tjetër pos i dhunshëm. U pa se liria e besimit nuk ishte në gjendje ta mbrojë besimin e lirë, gjë që doli se Juliani ishte i dënuar të dështonte siç ishte e dënuar të dështonte çfarëdo ideje e cila nuk kishte mbështetjen e masës, qoftë ajo edhe manipuluese në format siç

---

<sup>281</sup> Po aty, faqe 30.

<sup>282</sup> Po aty, faqe 31.

shfaqej. Këtë dështim e vulosi vdekja e tij nga një plagë që e mori në një betejë kundër persëve. Me të vdiq edhe vepra e tij, ndërsa dështimi i tij tregoi se fitorja e krishterimit ishte e pandalshme meqë prapa kishte masat të cilat ishin kthyer në peng të premtimeve për barazinë dhe jetën e përsipirtshme, të cilat do të kthehen në ideologji të shumtën rrënuese.

Fitorja përfundimtare e krishterimit ortodoks krijoi një frymë lehtësimi, pasi që ndaloi përndjekjet e përgjakshme që kishin vazhduar prej më shumë se dy shekujsh në Perandori, sado që nuk ndryshoi gjendjen shoqërore dhe atë politike në vend, e aq më pak fashiti grindjet brenda kishës, të cilat edhe për një kohë të mirë vazhduan me një hov të madh jo vetëm midis arianizmit dhe përkrahësve të Koncilit të Nikesë, pra lindorëve dhe perëndimorëve, por edhe midis ortodoksëve rreth dogmës *monofizite*, asaj *dyfizite* dhe të *pavendosurve*.<sup>283</sup>

Me këtë rast, po ashtu doli në pah se fuqia e madhe e liruar pas rrënimit të sistemit skllavopronar nuk ishte në gjendje që të krijonte rrethana më të mira ekonomike dhe as shoqërore. Përkundrazi, shumë nga ekonomitë që punonin mbi bazat e skllavërisë, me të shpejtë humbën prodhimin, ndërsa ngjashëm ndodhi edhe me ekonomitë bujqësore, minierat dhe punët e tjera publike. Ngecje shënoi edhe zejtaria dhe vetë tregtia, gjë që shumë qytete nisën të humbin rëndësinë e tyre. E vetmja degë, ku pas rënies së sistemit skllavopronar, shënoi njëfarë lëvizjeje përpara ishte bujqësia, ngase katundaria e lirë fitoi mundësinë që t'i rrisë pronat, ndërkohë që edhe pronarët e deriatëhershëm të tokave të përfshirë në sistemin e latifondeve përfituan nga format e reja të shfrytëzimit të saj me anën e kolonëve, që shfaqeshin si qiramarrës, që vinin nga radhët e katundarëve të shpronësuar. Ata merrnin me qira nga pronarët e mëdhenj tokë (*peculia*) bashkë me pajisjen e nevojshme për ta punuar dhe ishin të detyruar t'i jepnin të zotit të tokës një pjesë të prodhimit si edhe të bënin disa ditë punë angarie. Në radhët e kolonëve hynë edhe skllavërit që kishin fituar lirinë, robër që ziheshin në luftë si edhe pronarë të vegjël skllavërit që shkatërroheshin.<sup>284</sup>

---

<sup>283</sup> “*Dyfizitet*”, ose përkrahësit e “dy natyrave”, mbështetnin qëndrimin rreth ekzistimit të “dy natyrave” të Krishtit: hyjnore dhe njerëzore, që shfaqej me anën e konceptit të “njeriut perëndi”. Themelues i kësaj doktrine ishte Nestori i Aleksandrisë, i cili arriti të bëhet edhe peshkop i Kostandinopojës. Ndërsa “*monofizitet*” mohojnë natyrën njerëzore të Krishtit, duke mbështetur vetëm atë hyjnore. Në Koncilin e Katërt të kishës së krishterë në Kalcedoni më 451 u formua dogma mbi dy natyrat e Krishtit, që të dyja të përkryera, të pandalshme, por të dallueshme. Me këtë rast u dënua si *nestorizmi* ashtu edhe *monofizizmi*. Në raport me ta, formula e Kolcedonisë përfaqësonte në njëfarë mënyre një pozitë të mesme, sipas të cilës shpëtimi mund të vinte vetëm nga shpëtimtari që ishte në të njëjtën kohë Zot i përkryer dhe njeri i përkryer.

<sup>284</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i parë, Prishtinë, 1976, faqe 124.

Mund të thuhet se në përgjithësi *kolonati* mori një zhvillim të madh në provincat lindore qysh në fillim. Por, edhe pse gjendja e kolonëve ishte më e mirë se ajo e skllëverve, ajo solli forma të reja të shfrytëzimit, sistemi i ndryshëm i taksave, nga ajo e tokës, e bagëtisë dhe të tjerave që kërkonte shteti, filloi ta vështirësojë gjendjen e shtresës së lirë shoqërore, e cila shfaqej si shpresë e ekonomisë së re e cila në masë të madhe përligji sistemin bujkrob.

Kundruall këtyre rrethanave filloi të shfaqej pakënaqësia e kolonëve, e cila u shpreh me largimin e tyre nga ky sistem i ri i punës, me çka u paraqitën vështirësi të ndjeshme, të cilat detyruan pushtetin qendror që të merrte masa ndaj kolonëve që nuk u përgjigjeshin detyrimeve. Janë të njohura dekretet e perandorit Valentin të vitit 371 për Ilirinë, sipas të cilëve kolonët, të cilët deri më atëherë ishin *qytetarë të lirë*, filluan ta humbin lirinë në saje të ligjeve detyruese që i lidhnin me mënyrën e shfrytëzimit të saj, por edhe me anën e taksave të shumta të cilat bëheshin të papërbalueshme sa më shumë që Perandoria zhytej në luftëra me barbarët, të cilët kishin filluar me të madhe të futeshin nga Veri-lindja dhe Lindja, duke bërë plaçkitje dhe duke lënë shkatërrime të mëdha. Ekspeditat shkatërruese të barbarëve zunë të shpeshohen veçmas pas gjysmës së dytë të shekullit IV pas erës sonë kur turma të mëdha barbarësh nomadë, në radhë të parë Hunët zunë t'i shpërthejnë kufijtë dhe duke kaluar Danubin, të vendoseshin në territorin e Ilirikut Qendror. Ushtritë e Perandorisë nuk qenë në gjendje t'u bënin ballë këtyre sulmeve, por mbetej popullsia ilire-dardane ajo e cila, që të mbronte pronat e veta, duhej t'u bënte ballë atyre. Këtu duhet parë arsyeja pse fiset barbare nuk ishin gjithaq të suksesshme në këto pjesë, siç ishin ato të Gotëve dhe Visigotëve në pjesët lindore (Traki), të cilët pasi që do t'ia dalin që të përballojnë betejën e Adrianopojës të vitit 378 me ushtrinë perandorake të papërgatitur si duhej për kundërshtarë të tillë, ose pse do të ketë edhe të tillë që këtë faktor do ta llogarisë për hesape të caktuara të natyrave të ndryshme, të cilat do të dalin në pah më vonë (çështja e “vitalizmit” të Perandorisë me gjak të ri e kusuritje të tjera shoqërore dhe politike në raporte midis “perandorakëve” centralistë dhe “ushtarakëve” krahinorë), atyre do t'u hapet rruga drejt krahinave perëndimore të Ilirikut, depërtime këto të njohura, të cilat bënë që Gotët të arrinin edhe në brigjet e Adriatikut.

Kjo bëri që pasardhësi i Valentinit, Teodosi I, duke mos pasur mundësi tjetër që të dëbonte Gotët nga tokat e pushtuara, të hynte në marrëveshje me ta, duke u dhënë toka në pjesët veriore e perëndimore të gadishullit, me kusht që këta të merrnin përsipër të kryenin detyrën e shërbimit ushtarak për Perandorinë nën



udhëheqjen e komandantëve të tyre. Sipas kësaj marrëveshje që u quajt *foedus*, Ostrogotët do të vendoseshin në Panoni, ndërsa Visigotët në pjesën veriore të dioqezës trake. Në saje kësaj marrëveshje, Teodosi mundi të shmangte për disa kohë sulmet e reja të barbarëve dhe të siguronte “paqen” e brendshme shoqërore.<sup>285</sup>

Marrëveshjet me barbarët, megjithatë, nuk ia sollën paqen e brendshme Perandorisë e as nuk ia shtuan sigurinë e dëshiruar nga kërcënimet e jashtme. Përkundrazi, sipas reformave të Kostandin të Madh, perandoria tashmë e ndarë në dy pjesë, u përfshi edhe nga kundërthënie të brendshme shoqërore dhe ekonomike, që për pasojë patën edhe përplasjet dhe përçarjet e njohura politike, të cilat, në vitin 395, pas vdekjes së Teodosit, sollën ndarjen e Perandorisë në dy pjesë të veçanta e më vete: në Perandorinë Romake të Perëndimit dhe në atë të Lindjes të Kostandinopojës, të sunduara nga bijtë e tij Honori dhe Arkadi.

Kjo ndarje preku edhe Ilirikun ngaqë provincat veriore të tij (Noriku, Pannonia dhe Dalmacia) ishin në dioqezën e Ilirikut dhe, si rrjedhojë, pjesë politike e kishtarë e Perandorisë Perëndimore, ndërsa provincat ilire që përbënin dioqezën e Maqedonisë, u bashkuan përfundimisht me Perandorinë Lindore.<sup>286</sup>

Ndonëse këto provinca u vunë nënë varësinë politike të Kostandinopojës, nga pikëpamja fetare ato prapë mbetën nën juridiksionin e kishës së Romës, që si do të shihet në shqyrtimet e mëvonshme, kjo shpërputhje fatkeqe midis juridiksionit politik dhe atij kishtar në prefekturën e Ilirikut u dha rast të mirë peshkopëve që të shprehnin rivalitetin e tyre në rritje dhe të vinin në provë forcat, që do të jenë të kobshme për këto anë.<sup>287</sup>

Natyrisht se kjo ndarje ishte e pashmangshme dhe përfundimtare edhe për shkak se pas reformave të Dioklecianit dhe të Konstantinit të Madh qendra e gravitetit kaloi nga Perëndimi në Lindje, me ç’rast provincat qendrore, veçmas ato të Ilirikut, fituan një rëndësi të madhe dhe një funksion të rëndësishëm, që zhvendosi dukshëm raportin e forcave në dobi të Lindjes.

Përkundër kësaj ndarjeje e deri te rënia e Perandorisë Romake të Perëndimit, u ruajt ideja e unitetit të Perandorisë. Në ato rrethana nuk flitej më për dy perandori, por për dy pjesë të një perandorie të vetme, të cilat qeveriseshin nga dy perandorë.

Qeverisja e dy perandorëve si dhe dekretet e tyre në dukje të unifikuara, nuk i afruan Lindjen me Perëndimin. Përkundrazi Perëndimi filloi të dobësohet edhe

---

<sup>285</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i parë, Prishtinë, 1967, faqe 126.

<sup>286</sup> Jacques, Edwin: “*Shqiptarët*”, Tiranë, 2007, faqe 165.

<sup>287</sup> Po aty, faqe 165.

më nga depërtimet e barbarëve, siç ishin ato të Alarikut, i cili iu drejtua Italisë dhe pas tri përpjekjeve mundi të pushtojë e të plaçkitë Romën (410). Ndërkohë në Lindje, në fillimin e shekullit V fillon një periudhë relative e gjatë qetësie, gjë që u pa se barbarët, me të cilët u lidh paqe pas fitores së tyre në Adrianopojë, i sollën dobi Lindjes, ndërkohë që Perëndimin e ballafaquan me sprovën kryesore të shkatërrimit së cilës do t'i nënshtrohet pas pak, pikërisht nga Gotët dhe barbarët e tjerë, që ishin pranuar për ta “mbrojtur” Perandorinë, siç do të ndodhë në të vërtetë edhe me Sllavët, pas tre shekujsh, kur nga perandori Herakli do të pranohen që të mbrojnë Lindjen nga barbarët tjerë dhe për këtë do të vendosen në Ilirik, ku do të kthehen në shkaktarë të rrënimit të tyre dhe të frymës perëndimore, bartës të së cilës ishin Ilirët, me çka do të ndikohet edhe kthimi përfundimtar i Bizantit në Perandori lindore, të mbikëqyrur nga lindorët.

Megjithatë, deri sa do të vijë te ky rrënim i frymës perëndimore nga Sllavët në dobi të bizantinizmit lindor, në këtë periudhë “qetësie relative” u themelua universiteti në Kostandinopojë dhe u përhap *Codex Theodosianus*. Universiteti i ri u bë qendër e rëndësishme kulturore dhe arsimore e Perandorisë, ku jepnin mësim dhjetë Grekë e dhjetë latinë, pesë oratorë Grekë e tre latinë, një filozof e dy juristë.<sup>288</sup>

*Codex Theodosianus* i shpërndarë në Lindje dhe në Perëndim në emër të perandorëve Teodos II dhe Valentian III kishte një rëndësi, meqë kodi i ri i duhej t'i jepte baza të reja më solide administrimit të drejtësisë si shprehje e unitetit juridik të Perandorisë, i cili në të vërtetë hapi një periudhë paqeje midis dy gjysmave të Perandorisë, por që nuk e parandaloi procesin e ndarjes së saj, i cili ishte i pashmangshëm dhe gjithnjë e më i prekshëm.

Kësaj ndarjeje, megjithatë, shprehjen më të dukshme ia dha thellimi i ndarjes gjuhësore. Sepse, në Perëndim njohja e gjuhës greke erdhi duke u zhdukur, kurse në Lindje gjuha latine, ndonëse mbetej gjuhë zyrtare dhe si e tillë kultivohej jo natyrshëm, po humbiste vazhdimisht pozitën kundrejt gjuhës greke. Kështu, greqizimi i Lindjes përparoi pa u ndalur, sidomos në kohën e perandorit Teodos II dhe të perandoreshës Eudokia Augusta.<sup>289</sup>

Ndarja gjithnjë e më e madhe gjuhësore, që në të vërtetë paraqiste edhe ndarjen midis dy botëkuptimeve politike, shoqërore dhe kulturore, atij lindor dhe perëndimor, në të vërtetë, në lindje solli edhe krijimin e një kulture *kishtare-kom-*

---

<sup>288</sup> Ostrogorski, Georg: “*Historia e Perandorisë Bizantine*”, Tiranë, 2002, faqe 32.

<sup>289</sup> Po aty, faqe 33.

*bëtare*, e cila u paraqit në Armeninë fqinje, ku u shfaq *alfabeti armen* dhe përkthimi i *Biblës në armenisht*.<sup>290</sup>

Ky ishte një hap i rëndësishëm rreth formimit të *ndërgjegjes kombëtare-etnike*, që Bizanti e synoi dhe pak nga pak ia doli ta ngritë në një shkallë të përgjithshme me të cilën të krishterët do të ushqehen për t'u mbajtur të lidhur për bizantinizmin.

Përcaktimi i kishës së Bizantit për *ndërgjegje kombëtare fetare*, nuk do të gjejë mbështetje nga kisha romake. Ndonëse Perandoria Perëndimore, për shkak të sulmeve barbare, veçmas të Hunëve, ndodhej para grahmës, sërish dëshmoi përcaktimin për *unitetin romak* mbi qëndrimet e njohura të kishës së Romës rreth konceptit universal të qytetërimit, të cilit edhe më këndeje mëtohej t'i mbetej besnik. Ishte papa Leoni (Luani) i Madh (640-661), i cili vuri në pah se kisha romake mbetej fuqi romake që nuk hiqte dorë nga dogma universale e krishterë, pavarësisht se Perandoria Perëndimore do të zbresë përfundimisht nga skena historike pikërisht pse i mungonte identifikimi etnik dhe kombëtar siç ngjau me kishën lindore, e cila, me pranimin e autoqefalisë, atë e shndërroi në mjet të fuqishëm mbijetimi, qeverisjeje dhe pse jo edhe sundimi politik madje.

Në të vërtetë në përputhje me unitetin romak, i cili kishte bazën te dogma e krishterë si dhe përpjekjet e mëdha që me anën e reformave të gjera administrative, politike dhe shoqërore të kthehet në një emërues të përbashkët të Perandorisë me “dy krahë” (atë lindor dhe perëndimor), duhet parë edhe shfaqjen e *tri identiteteve iliro-dardane* brenda atij perandorak: atij *vetëqeverisës*, *administrativ* dhe *kishtar dhe juridik*.

*Identiteti vetëqeverisës* - njihet që nga pushtimet e para të Romës përtej Adriatikut, kur ushtria romake, pas luftimeve të gjata, do të detyrojë mbretin Genc të pranojë vasalitetin, ndërkohë që do të përgatitë terrenin për pushtime të tjera në drejtim të Ardianëve, Dalmatëve si dhe të fiseve dhe mbretërive në Epir dhe Dardani. Në të vërtetë vetëqeverisja dhe autonomia e brendshme do të bëhen mbi bazat e identiteti etnik, andaj jo pa të drejtë *vetëqeverisja* është quajtur edhe *identitet etnik*, meqë bazë e saj ka qenë etnia, e cila jo vetëm që është ruajtur, por edhe është forcuar.

Ky parim ka qenë në përputhje me politikën e njohur romake “*pax romana*”, me çka përfshirja e pjesëve të tjera në Perandori, veçmas atyre strategjike çfarë ishte Iliriku, Dardania, Maqedonia, por edhe Trakia dhe pjesë të tjera në Lindje

---

<sup>290</sup> Shih: Stein: “*Geschichte*”, I, 425; A. Mikelian: “*Die armenische Kirsche in iren Beziehungen zur byzantinischen*”, 1892.

dhe në Afrikë, nuk do të thoshte nënshtrim i plotë në përputhje me pushtimin, por një si marrëveshje për një perandori të përbashkët e ndërtuar mbi parimet e universalizimit botëror, që më vonë do të plotësohen me ato të boshtit të krishterë (ekumenizmit). Andaj, mbi këto parime shfaqen edhe statuset e provincave vetëqeverisëse, ato të autonomive të brendshme (fisnore) dhe të tjera, ku krahas ndonjë tributi të lehtë si dhe detyrimeve ushtarake, të tjerat do t'u lihen vendësve për t'u vetëqeverisur dhe zhvilluar, me kusht që zhvillimi i brendshëm të mbështetet mbi prioritet e përbashkëta perandorake dhe të jetë në shërbim të tyre prej nga do të përfitojnë të gjithë.

Format e vetëqeverisjes dhe të autonomive të brendshme kanë qenë të ndryshme dhe kanë evoluuar në përputhje me rrethanat si dhe interesat e Perandorisë romake në këto pjesë. Këto forma të organizimit administrativ të Perandorisë do të vazhdojnë edhe pas pushtimeve të plota të viseve ilire nga mesi i shekullit të dytë para erës sonë e këndeje. Ato kanë paraqitur instrumentin më të rëndësishëm të përfshirjes por edhe të integritetit të Ilirisë në strukturat ekonomike, shoqërore dhe politike të Perandorisë prej nga do të fillojë edhe procesi i romanizimit për të cilin është folur më parë si për një zhvillim të natyrshëm, i cili në një fazë të caktuar, veçmas kur do të shfaqen sulmet e barbarëve në veri dhe veri-lindje që rëndom kalonin nëpër tokat ilire dhe dardane, do të prodhojë vetëdijen se mbrojtja e Perandorisë nga barbarët njëhershëm do të thotë mbrojtje e vendit të tyre.

*Identiteti administrativ* - paraqet një fazë tjetër, kur identiteti vendor-etnik, i ruajtur dhe i zhvilluar gjatë vetëqeverisjeve të brendshme, ngrihet në një shkallë më të lartë shoqërore dhe politike, ku rrathët e caktuar zgjerohen në një rreth më të madh dhe funksionimi i ndërsjellë i nënshtrohet një hapësire më të madhe. Kjo formë e organizimit administrativ theu barrierat e njohura fisnore dhe krahinore, karakteristike për një pjesë të fiseve ilire, të cilat edhe pa qenë të pushtuara nga Roma, kanë qenë të mbyllura nga pikëpamja ekonomike dhe shoqërore, ndërkohë që hapja krijoi mundësi për ndërlidhje të reja, të cilave u duheshin edhe formatadekuete qeverisëse, pale se pastaj do të vijë edhe deri te shkrija e tyre në një shtresim të përbashkët, i cili megjithatë mbetet në kuadër të etnosit të tyre të njohur.

Gjatë kohës së Dioklecianit njësitë e shumta vetëqeverisëse si dhe ato që gëzonin autonominë e brendshme dhe fisnore në kuadër të formave të tjera organizative të njohura, do të përfshihen në njësi të përbashkëta administrative. Kështu, siç dihet, sipas reformës së Dioklecianit krijohet provinca e madhe e Ilirikut, njëra ndër katër prefekturat e Perandorisë, e cila ndahej në 12 dioqeza. Është i

njohur vendimi i vitit 292 kur Perandoria e ndarë në katër prefektura kishte katër Cezarë, dy prej tyre me prejardhje ilire: Konstantin Klori dhe Galeri. Këtij të fundit iu la ta qeveriste Ilirikun, hapësira e së cilës niste nga *Dalmacia* shkonte deri te Danubi në veri, ku përfshiheshin në *Prevalime* qendër Scodrën dhe bënin pjesë Dalmacia e Jugut, Dioklea (Mali i Zi i sotëm) dhe pjesa e Scodrës, pastaj vinte *Dardania* me qendër Scupin, ku hynin viset qendrore të Dardanisë (me ato të Maqedonisë së sotme deri në Astibo), ndërsa në provincën e *Epirit të Ri* me qendër Dyrrahun përfshiheshin krahinat nga Adriatiku e deri te lumi Vjosa. *Epiri i Vjetër* me qendër Nikopolin përfshinte tokat në jug të Vjosës e deri te gjiri i Prevezës.

Bashkimi i këtyre krahinave në një provincë administrative ishte me dobi të shumëfishtë si për bashkimin e brendshëm të njësive vetëqeverisëse dhe autonome me statusin e *civitateve, muncipeve, kasteleve* dhe të *kolonive autonome*, ashtu edhe për atë të jashtëm, meqë ato ktheheshin në njësi të mëdha administrative, ku prefektët ishin qeveritarë vendorë të rangut të parë. Ata ishin të pavarur për të qeverisur dhe administruar dioqezat, të cilat lidheshin me interesa të përbashkëta në kuadër të provincës, ku përfaqësoheshin në mënyrë të barabartë.

Kështu, qeverisja administrative e Ilirikut me katër dioqeza të mëdha, krijoi identitetin e parë administrativ të një natyre që ishte formë e *shtetësisë autonome*, meqë me organizimin e ri prefektët vendorë përfaqësoheshin drejtpërdrejt në atë të provincës, ku autoritet kryesorë dhe i dyti i Perandorisë ishte cezari, i cili bashkëqeveriste me Perandorin e Romës.

Shikuar nga ky aspekt, krahas të drejtës së vjeljes së taksave, mbikëqyrjes së rrugëve perandorake që kalonin nëpër këtë pjesë, të cilat ishin një që lidhnin Perëndimin me Lindjen (Via Egnatia, ajo e Adriatikut dhe ajo që lidhte Dyrrahun me Thessalonikun dhe Kostandinopojën dhe të tjera në shumë drejtime), ishte edhe aspekti i sigurisë, që këto pjesë i bënte edhe më të rëndësishme, meqë ato me ruajtjen e fortifikimeve, merrnin pjesë drejtpërdrejt në konceptin strategjik të mbrojtjes së Perandorisë.

Si do të shihet *identiteti administrativ* i Ilirikut pas pak do të fitojë edhe më në peshë, veçmas në kohën e Konstantinit të Madh, pasi të pranohet krishterimi. Meqë mbi këtë organizim do të bëhet edhe ai kishtar, *peshkopata Ilire* zuri njërin ndër vendet kryesore në hierarkinë kishtarë perandorake, që do të thotë njëherësh edhe pushtet politik dhe shoqëror. Si do të shihet, do të jenë peshkopët nga Iliriku dhe Dardania ata të cilët që nga Koncili i parë i Nikesë në vitin 325 e deri te ai i teti i Kostandinopojës, më 870, me atë që juridiksioni fetar jo gjithnjë do të ndjekë atë administrativ, pra që Iliriku do të mbetet i lidhur me kishën e Romës,

ndërsa administrativisht do t'i takojë Lindjes, pra Kostandinopojës. Në gjashtë shekuj rresht kjo do të paraqesë një "precedent" mbi të cilin do të thyhen përvijimet e njohura Lindje-Perëndim të përmasave të njohura që më vonë do të shkojnë edhe deri te ato të ndeshjes së qytetërimeve.

*Identiteti kishtar dhe ai juridik* - në Perandorinë e Bizantit shfaqet edhe si identitet shtetëror jo vetëm për atë që në saje të marrëveshjes me kishën perandori paraqiste "përfaqësuesin e zotit" në tokë, por edhe për faktin se kisha shfaqej edhe si bashkëqeveritare e njëmendët në fronin perandorak, por edhe në disa segmente të rëndësishme të pushtetit vendor kur ajo përcaktonte edhe autoritetet vendore si dhe fuqinë e tyre në raport me hierarkinë e pushtetit qendror. Kështu, perandori dhe kisha, ushtronin pushtet të përbashkët në të gjitha fushat e jetës, prej nga pastaj aspektet shpirtërore që drejtonte kisha, duhej të drejtonin ato të vetëdijes, e cila fund e krye duhej t'i nënshtroheshin dogmës së krishterë dhe ato të gjenin shprehje në jetën shoqërore, atë intelektuale dhe krijuese.

Me organizimin kishtar kishat e Ilirikut, pjesa e tyre më e madhe (me përjashtim të dioqezës së Dyrrahut) do t'i takojnë kishës romake. Fillimisht qendra e tyre do të jetë në Thesalonik, në mënyrë që në kohën e Justinianit I e këndej kjo qendër, në rang të vikariatit, të kalojë në Prima Justiniana, ku do të mbetet për më shumë se dy shekuj e gjysmë, përderisa, në shekullin IX, do t'i kalojë nën mbikëqyrjen përfundimtare Kostandinopojës.

Në përputhje me këtë qëndrim Justiniani mori masa të veçanta ndër të cilat duhet dalluar krijimin e një dioqeze të veçantë për kishat e Ilirikut duke e shkëputur nga varësia e Thesalanikut. Pastaj ndërtimin e një qyteti madhështor në të cilin ngriti arqipeshkvinë me juridiksionin mbi të gjitha kishat e provincave të Ilirikut. Arqipeshkvi (kryepeshkopi) ishte njëkohësisht edhe vikar i selisë apostolike të Romës. Institucionalizimi i kësaj arqipeshkvie u bë me Novelën XI të 14 prillit 535 të vendosur në qytetin e ngritur të cilit i dha emrin: "Prima Justiniana" që shprehimisht e quan vendlindja ose atdheu i tij.<sup>291</sup>

Edhe para se kryeqendra e kishës së Ilirikut të kalojë në Dardani dhe aty të marrë edhe rolin e vikariatit, në Ilirik dhe veçmas në Dardani, kisha e kësaj pjese, në kuadër të përvijimeve të njohura teologjike dhe kundërthënieve të pasqyruara me ndarje brenda kishës (*arianizmi* dhe doktrinat e ndryshme për dhe kundër

---

<sup>291</sup>Emri i vërtetë i vendndodhjes së kësaj kryekishe është "Prima Justiniana" që perandori e shpreh qartë në tekstin e Novelës XI ku përmbahet: "*Multis et varis modis nostram patriam augere ut...Prima Justinianae nostram patriam...*" Por është deformuar nga historiani bashkëkohës i Justinianit, Prokopi i Cezaresë i cili në veprën "*De aedificiis*" (Mbi ndërtimet) jep të dhëna historike që perandori Justinian ndërtoi një qytet madhështor të cilit i dha emrin "Justiniana prima".

*trinitetit*), do të paraqesë një faktor të rëndësishëm si katalizator i këtyre rrymeve dhe konfrontimeve jo rrallë të skajshme. Dihet se Shën Pali udhëtimet e tij të para apostolike në pjesën perëndimore do t'i bëjë në këto pjesë dhe aty, pasi që do të fusë idenë e ungjillit të krishterë njëherësh, do të krijojë ngulimet e para kishtare në këto anë. Po ashtu në këto anë do të shfaqet edhe Shën Jeronimi me përkthimin e parë të Biblës në gjuhën latine (Vulgata) në vitin 399, me çka do t'i hapën rrugët e mëtejshme zyrtarizimit të krishterimit, siç do të ndodhë pak më vonë nga perandori Konstantini i Madh që vinte nga viset dardane.

Megjithatë, ajo që mund të quhet *identitet kishtar* i dalë nga niveli organizativ, siç ishte ai që Dardania fitoi në kohën e perandorit Justiniani I, len mundësinë që të vlerësohet edhe si *pjesë e identitetit shtetëror* brenda atij perandorak, meqë kjo do të pasqyrohet jo vetëm në aspektin shpirtëror, kur vikariati i Jusiniana Prima ngrihet në rangun më të lartë të lidhjes së drejtpërdrejtë me papatin e Romës, por edhe në atë shoqëror dhe politik në një rrafsh të gjerë. Kështu, gjatë kohës së Justinianit, gjithnjë në përputhje që kryeqendra e arqipeshkvisë së Ilirikut të ketë edhe përmbajtje materiale, krahas ndërtimit dhe kthimit të Prima Justiniana në një qytet madhështor, ngjashëm do të veprohet edhe me qendrat e tjera të Dardanisë nga Naissusi, që do të rindërtohet. Pastaj Ulpiana e shkatërruar nga tërmeti i vitit 518 që do të emërtohet Justiniana Secunda si dhe shumë qytete të tjera, të cilave duhet shtuar edhe ngritjen e mbi njëqind kështjellave anembanë vendit. Ndonëse do t'u dedikohen çështjeve të sigurisë, pra mbrojtjes së vendit nga sulmet barbare, të cilat kishin filluar dhe kërcënonin me të madhe, veçmas ato të Gotëve, Avarëve dhe pak më vonë edhe të Sllavëve, ato do të forcojnë jetën ekonomike dhe shoqërore të vendit, duke e kthyer atë në një qendër të fuqishme që lidh Lindjen me Perëndimin. Të dhënat e kohës tregojnë se niveli i tillë shpirtëror, shoqëror dhe politik kushtëzoi edhe ngritjen dhe forcimin e klasës së re ushtarake dhe të aristokrate vendore, e cila ndjehej e baras-vlerësuar me atë të elitës perandorake.

Identiteti kishtar i kishës dardane në Ilirik i lidhur me atë romak, edhe pse në shek. IX me urdhrin e perandorit Leoni III, përfundimisht do të kalojë nën juridiksionin e kishës lindore, pra të Kostandinopojës, do të mbetet pjesë e një tradite disashekullore kishtare, që do të ndikojë edhe në shfaqjen e strukturave të para parashtetërore bizantine, siç ishin ato të *temave* të krijuara në Durrës dhe Nikopojë.

Identiteti kishtar për të cilin u bë fjalë, megjithatë, lidhet edhe me atë juridik dhe atë administrativ, ku u përqendrua Justiniani I, me çka ai synoi që të realizonte unitetin politik perandorak Lindje-Perëndim, nën një pushtet të vetëm.

Pastaj të vendoste një legjislacion të vetëm në të gjithë perandorinë që të sundonte një e drejtë e vetme e shtetit, siç ishte ajo që u promovua me shfaqjen e “*Codex Justinianus-Corpus Juris Civilis, Novela XI*”.

## KRISHTERIMI NË DARDANI, MAQEDONI DHE ILIRIK

Nëse mund të thuhet se në Ilirik, ku Dardania dhe Maqedonia si provinca luanin një rol të rëndësishëm në strukturat vetëqeverisëse, do të fillojnë proceset kyçe (reformat perandorake të Dioklecianit dhe të Konstantinit të Madh si dhe depërtimet e para të barbarëve nga Lindja drejt Perëndimit, që do të çojnë te lindja por më vonë edhe te krijimi i Bizantit), e njëjta mund të thuhet edhe për shfaqjen e krishterimit. Sprovën më të rëndësishme për tretmanin që do ta fitojë në shekullin IV, kur do të kthehet në besim zyrtar të Perandorisë, krishterimi do ta ketë në këtë pjesë, meqë nëpër këto vende kalonin rrugët kryesore që lidhnin Lindjen me Perëndimin dhe anasjelltas, kështu që ato ishin të pashmangshme qoftë për qarkullimin e mallrave, të ushtrive, por edhe të ideve.

Të dhëna e ndryshme të autorëve antikë, si dhe burimet kishtarë, bëjnë të ditur se misionarët e krishterë u shfaqen në hapësirën e Ilirisë dhe të Dardanisë qysh në shekullin e parë pas e.r. Autori i shekullit VI pas erës sonë, Kosmas, i përfshin Ilirët në grupin e popujve që në kohën e tij kishin përqafuar krishterimin.<sup>292</sup> Që në shekujt e parë të erës së re, në qendrat urbane të këtyre trevave përmenden bashkësitë e para të krishtera, si dhe ngrihen ndërtesat e para të kultit të tillë.<sup>293</sup>

Burimet kishtarë bëjnë të ditur se Shën Pali e kishte futur për herë të parë literaturën sakrale në Ilirik siç ishte Ungjilli i krishterë, në Filipe të Maqedonisë. Pastaj, duke udhëtuar drejt Perëndimit, nëpër rrugën Egnatia, predikoi në Selanik prej nga pastaj, në vitin 59 pas erës sonë, për herë të parë, do të depërtojë edhe në zemrën e Ilirikut. Rreth kësaj ai thotë:

“Nga Jerusalemi dhe rreth e për rreth deri në Ilirik përhapja lajmin e gëzueshëm për Krishtin”.<sup>294</sup>

Po, nuk ishin këto të vetmet të dhëna ku Shën Pali përmend Ilirikun. Rreth viteve 66 pas erës sonë ai i shkruante Titit si kishte mbetur në Nikopojë gjatë dimrit, në qytetin më të njohur të Epirit, si thotë, në një vend pranë Ilirikut, të

<sup>292</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi parë, Tiranë, 2002, faqe 200.

<sup>293</sup> Po aty, faqe 20.

<sup>294</sup> Gjini, Gaspër: “*Skoposko-prizrenska biskupija kroz stolejca*”, Zagreb, 1986, faqe 21.



cilin e quan “qytet të fitores”, të cilin e kishte themeluar Augusti në vitin 31 para erës sonë, pasi që kishte mundur kundërshtarin e tij Antonin.<sup>295</sup>

Nga të dhënat kishtare bëhet e ditur se me këtë rast Shën Pali kishte themeluar në Durrah një bashkësi të krishterë, të parën në këto anë, gjatë predikimeve të tij në Iliri dhe Epir.<sup>296</sup> Këtu mund të kuptohet se aso kohe në Durrah ndodheshin 70 familje të krishtera, të cilat kishin si peshkop njëfarë Cezari apo Apolloni.<sup>297</sup>

Burimet nga kisha romake bëjnë të ditur se i kësaj kohe ishte edhe martirizimi i peshkopit të Durrahut, Shën Astit, i cili u martirizua nga perandori Trajan në kohën e sundimit të tij (98-117).<sup>298</sup>

Shfaqjen e emisarëve të krishterë, që do të shpallen shenjtorë, siç ishte Pali dhe të tjerë si dhe praninë e mirë të përkrahësve të tyre në Ilirik e dëshmon historiani, Plini i ri, i cili në vitet 111 dhe 113 pas erës sonë qeveriste Bitininë dhe Pontin. Plini shkruan se “epidemia e këtij mashtrimi” siç e quan krishterimin, “kishte përfshirë jo vetëm qytetet por edhe katundet”.<sup>299</sup>

Praninë e kulteve fetare në “qendrën e botës” (*in medio mundi constitutae*) siç u quajt atëherë Iliriku nga shumë autorë,<sup>300</sup> e ndeshim edhe te Tertulijani (200-206) kur ai bën fjalë për përhapjen universale të krishterimit edhe te Trakët dhe fqinjët e tyre, gjë që kjo len për të kuptuar se fjala ishte edhe për Dardanët, të cilët asokohe jetonin në një provincë të përbashkët me ta në atë të Mëzisë Superiore, e ku sipas burimeve antike ata mbikëqyrnin rrugët që lidhnin lindjen me Perëndimin.

Për Dardaninë dhe rëndësinë e saj, si qendër ku nga fundi i shekullit të parë pas erës sonë dhe fillimi i të dytit, do të qarkullojë me të madhe ideja e krishterimit, mund të kuptohet edhe prej dy shenjtorëve dardanë, Florit dhe Laurit, të cilët në Ulpianë përfunduan si martirë.

Edhe pse nuk dihet me saktësi koha e martirizimit të tyre, nga burimet e tërthorta ajo mund të lidhet me fillimet e shekullit të dytë para erës sonë, meqë të dhënat kishtare vërtetojnë se mësuesit e Florit dhe të Laurit, Pokuli dhe Maksimi, do t’u nënshtrohen torturave gjatë kohë së perandorit Hadrijan (117-138), mund të merret me mend se edhe nxënësit e tyre do të pësojnë diku afër mësuesve.<sup>301</sup>

---

<sup>295</sup> Po aty, faqe 21.

<sup>296</sup> Shih Farlati: “*Illyricum Sacrum*”, I, 254; VIII, 1.

<sup>297</sup> Po aty.

<sup>298</sup> Jacques, Edwin: “*Shqiptarët*”, Tiranë, 2002, faqe 159.

<sup>299</sup> Po aty, faqe 21.

<sup>300</sup> Irenaeus, Lugdunen: “*Contra haereses*”, libri I, cap. 10, PG 7 553/4.

<sup>301</sup> *Acta Sanctorum*, die 18 Augusti, III, Antverpiae 1737, 520-522, cituar sipas Gjini, Gaspër: “*Skopsko-prizrensaka biskupija kroz stoljeća*”, Zagreb 1986, faqe 23.

Se ndikimi i krishterimit në Dardani të Ilir ku ishte në rritje e sipër dhe nuk ishte e rastit që aty kishte marrë hov edhe martirizimi, kjo mund të kuptohet edhe nga misionarët e njohur që do të shpallen shenjtore nga këto anë. I pari ndër ta është Gërguri i Nishit, i lindur në vitin 344. Pas tij vjen Shën Jeronimi (Hieronymus), i lindur në vitin 347 në Stridom, në kufirin verior të Dalmacisë, pastaj Ariusi, shkrintar dhe peshkop i qytetit Amazehja në Azi të Vogël, që ishte nga këto anë.

Ndër të gjithë shenjtërit e Ilirikut dhe të Dardanisë, i cili pa mëdyshje se paraqet njërin nga etërit dhe teologët më të shquar kishtarë, është Shën Jeronimi, i quajtur Hieronymus (347-420). Pos të tjerash ai mbahet mend veçanërisht për përkthimin e Biblës, të njohur si *Vulgati Latin*.<sup>302</sup>

Se çështja e shenjtoreve dhe martirëve në Iliri dhe Dardani nuk ishte jashtë ndjeshmërisë më të thellë për krishterimin, e dëshmojnë një sërë emrash vendesh që u referohen martirëve të parë të Lindjes, kulti i të cilëve ka qenë i përhapur në shekujt IV-VI. Të tilla janë toponimet *Shirgj*(Shën Sergj), *Shumbak* (Shën Baku), *Shëndekla* (Shën Teka), *Shën Vlashi*, që ndeshet në Shkodër, Durrës e deri poshtë në Çamëri, *Shnanou*(Shën Ndou) Gjakovë, *Shijaku* (Shën Jaku)etj.<sup>303</sup>

Edhe para veprës së madhe misionare të Shën Jeronimit, i cili përktheu Testamentin e Vjetër në gjuhën latine dhe atë e vuri në kontakt për herë të parë me botën perëndimore me përmbajtjen e saj, shënohet ekzistenca e krishterimit në Ilirik dhe Dardani me praninë e peshkopëve të këtyre anëve në Koncilin e Nikesë, të vitit 325, të cilin e thirri perandori Konstantin i Madh. Në Këshillin ekumenik të Nikesë, nga 318 peshkopë të përfaqësuar nga e gjithë Perandoria, 3 ishin nga Iliriku, ndër të cilët dy ishin nga Dardania dhe një nga Iliriku. Nga Dardania ishte peshkopi i Scupit (Shkupit të sotëm) Dacus ose "*DacusDaradaniae*" dhe peshkopi Budius i Stobit (Shtipit të sotëm në Maqedoni) dhe nga Iliriku ishte peshkopi i Korkyrës (Korfuzit). Duket se peshkopi i Stobit Budius ishte nën mbikëqyrjen e Dacusit të Dardanisë, gjë që flet për shtrirjen e kishës së Dardanisë deri në pjesët e Maqedonisë,<sup>304</sup> shtrirje kjo që në këto anë edhe në organizimet e mëvonshme kishtarë do të dëshmohet. Me këtë rast Harnaku pohon se në vitin 325, në Ilirik, qendrat kishtarë ishin të pranishme në Nikopojë, Buthrotum (Butrint) dhe Korkyra (Korfuz).<sup>305</sup>

---

<sup>302</sup> Jacques, Edwin: "*Shqiptarët*", Tiranë, 2002, faqe 170.

<sup>303</sup> "*Historia e Popullit Shqiptar*", vëllimi i parë, Tiranë, 2002, faqe 200.

<sup>304</sup> Gjini, Gaspër: "*Skopsko-prizrenska biskupija kroz stoljeća*", Zagreb, 1986, faqe 29.

<sup>305</sup> Jacques, Edwin: "*Shqiptarët*", Tiranë, 2002, faqe 163.

Po në këtë kohë në toponomastikën e vendit futen emra të krishterë të tipit *Shëngjin, Shupal* ( Shën Pal), *Shmil* (Shën Mëhill), *Shën Koll* apo *Shën Nik* (Shën Nikollë), *Shëndill* (Shën Ilia) *Shëngjergj, Shtish*(Shën Matish), etj.<sup>306</sup>

Pas njohjes së krishterimit si besim të Perandorisë që u bë nga perandori Konstantini i Madh krishterimi në Ilirik mori hov pasi që u organizua mbi bazën e provincave administrative të epokës së Dioklecianit. Kështu, në qendrën e çdo province ndodhej kisha metropolitane dhe aty e kishte selinë kryepeshkopi. Nën juridiksionin e këtij të fundit ndodheshin peshkopët e dioqezave vartëse (sufragane). Në qendrat kryesore të Ilirikut ishin kryepeshkopata e Shkodrës (Prevali), Scupi (Dardani), Durrësi (Epiri i Ri) dhe Nikopoja (Epiri i Vjetër). Kryepeshkopi i Shkodrës kishte nën varësi 3 peshkopata vartëse; i Scupit kishte 5: i Durrësit 8 dhe i Nikopojës 9.<sup>307</sup>

Në kuadër të këtij organizimi nëpër provinca, kryepeshkopi thërriste sinodin provincial. Kryepeshkopët merrnin pjesë në koncilët ekumenike, siç ishte ai i pari i Nikes, ku mori pjesë mitropoliti i Durrësit. Ndërsa në Koncilin e Kalcedonisë të vitit 451, kur u zgjidhën përfundimisht grindjet dogmatike mbi natyrën e Krishtit, morën pjesë Lluka - Mitropolit i Durrësit, Evendri - peshkop i Dioklesë dhe Euzebio - peshkop i Apollonisë.<sup>308</sup>

Organizimi kishtar në Ilirik ndau fatin e vështirësive që kaloi organizimi i përgjithshëm i kishës në Perandori nga lejimi i saj në shekullin IV nga Kostantini i Madh e deri te Koncili i Kalcedonisë kur fitoi dogma mbi natyrën e Krishtit dhe u mendua se do të mbizotërojë paqja e brendshme kishtare. Por, meqë Iliriku ndodhej në pjesën më strategjike të Perandorisë, pra në atë që ndante Lindjen me Perëndimin dhe ku gjendej nyja e të gjitha përvijimeve të njohura nga ato politike, shoqërore, kulturore e fetare, ishte e natyrshme që në të të pasqyroheshin që të gjitha përvijime dhe krizat në mënyrë të veçantë. Kështu, nuk ishte e rastit se mbi këtë pjesë filloi edhe ballafaqimi i parë dhe më i ashpri midis Romës dhe Kostandinopojës për hegjemoni kishtare, dhe se kjo doli në pah nga koncili i dytë dhe i treti për të kulmuar veçanërisht gjatë të ashtuquajturës “*Krizë akaciane*” (484-519), kur peshkopët e Ilirikut konfirmuan besnikërinë ndaj Romës. Veçanërisht të vendosur për komunikim me Papën ishin kleri provincial i Dardanisë, Epirit të Vjetër dhe Prevalit.

---

<sup>306</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i parë, Tiranë, 2002, faqe 201.

<sup>307</sup> Po aty, faqe 201.

<sup>308</sup> Po aty, faqe 202.

Në të vërtetë, kjo krizë kishte për rrjedhojë krizën politike që vazhdonte midis qendrave: Romës dhe Kostandinopojës, ku secila luftonte për primat, edhe pse me Koncilin e Kalcedonisë të vitit 451, në bazë të kanunit 28 të tij kishte barazuar peshkopët e Romës me atë të Kostandinopojës, kështu që ata ishin të barabartë. Papa Leoni nuk deshë ta pranonte atë kanun, të cilin e hodhi poshtë, jo me superioritetin politik të Romës, por me përparësinë fetare të Shën Petrit. Kjo bëri që atij t'i shkonin pas peshkopët e Ilirikut bashkë me ata të Dardanisë, të cilët si mbështetje kishin edhe një vendim të koncilit të fundit, i cili vuri dioqezat lindore nën varësinë e Patriarkut të Kostandinopojës, por nuk ia dha autoritetin mbi Ilirikun.

Në këto rrethana, sërish do të jenë lëvizjet politike në kreun perandorak ato që do të ndikojnë edhe rreshtimet kishtare, me anën e të cilave do të thyhet uniteti i peshkopatave të Ilirikut që të ruajnë përkatësinë romake. Ishte peshkopata e Durrahut ajo e cila filloi të anonte kah Kostandinopoja nga shkak i vetëm se perandori Anastasi I (491-518) kishte prejardhje nga Durrahut, gjë që ndikoi që të reflektohej kah kisha lindore.

Këtyre konfrontimeve fetare të natyrës perandorake, pra së pari të atyre me arianizmin e më vonë edhe mes “*dyfizitëve*” (të dy natyrave) dhe “*monofizitëve*” (të njeriut perëndi), sigurisht se një skenë të veçantë veprimi do t'u japë vetë organizimi i kishës që do të ndjekë ndarjen administrative të provincave që ishte bërë sipas modelit fillimisht të Dioklecianit e mandej të Konstantinit të Madh. Sipas kësaj Iliriku ishte i ndarë në dy pjesë: në atë të Perëndimit nën drejtimin e “*praefecturaspr. Italiae, Africae et Illyrie*” dhe në atë të lindjes, që ka pasur prefektin e vet “*praefectuspr. Illyrici*”. Ilirikut lindor, në përbërje të të cilit do të gjenden dioqezat e Dardanisë dhe ajo e Maqedonisë, perandori Graciani më 379, ia la ta drejtonte bashkëqeverisësit Teodosi. Pjesa perëndimore e Ilirikut pak më vonë, më 423 e 437, iu bashkua Perandorisë Lindore.

Këtë ndarje nuk e pranoi papa Bonifici, i cili menjëherë kërkoi nga Honori, që drejtonte pjesën perëndimore të Perandorisë, që kisha e Ilirikut t'i kthehet sërish Romës. Honori i shkroi një letër Teodosit duke ia parashtruar kërkesën e Selisë së Shenjtë “*saneta esedisa postolica e desideria*”. Teodosi pranoi këtë kërkesë dhe shpalli dekretin sipas të cilit prefektit të Ilirikut i urdhërohej të ruante rendin e vjetër “*aniquuom ordiner specialitet faciant custodiri*”.<sup>309</sup>

---

<sup>309</sup> Rreth çështjeve kontestuese të letërkëmbimit midis Bonificit dhe Honorit më gjerësisht shih: “*Acta et diplomata res Albaniae mediae actatis illustration, colleg*”. Thalloszy L.-Jericek C.-Suflay E, vol. I, Vindibonae MCMXIII, 2 nr. 9-10.

Kjo gjendje, pra kur të gjitha provincat e Ilirikut lindor ishin jo vetëm të pavarura dhe të lidhura me juridiksionin e peshkopit të Romës, do të vazhdojë deri në gjysmën e shekullit IX. Kjo, megjithatë, nuk do të thotë që nuk do të ketë përpjekje që atyre t'u merret përkatësia kishës perëndimore, siç ishin ato të kryepeshkopit të Kostandinopojës Anatolit kur do t'u shkruajë peshkopëve të provincës lindore të Ilirikut që të pajtohen rreth kanonit 28 të koncilin të Kalcedonisë të vitit 451 me anën e të cilit selisë së Kostandinopojës t'i jepej përparësi. Nga letra e papës Leon mësohet se peshkopët e Ilirikut do ta refuzojnë kërkesën e patriarkut Anatoli.<sup>310</sup>

Në kuadër të këtyre përvijimeve kishtare, të cilat kanë ndikuar edhe në jetën shoqërore dhe politike, duhet parë edhe rolin e peshkopatës së Dardanisë, si një-rën ndër nismëtare e organizimit kishtar në atë që nga perandori Dioklecian do të përfshihet në pjesën e Ilirikut si një provincë e pavarur e një rëndësie të veçantë.

Në të vërtetë *termi Ilirik*, i një natyre administrative që do të zyrtarizohet në kohën e Dioklecianit dhe do të pranohet edhe nga Kostantini i Madh për të mbetur i tillë edhe gjatë kohës së Bizantit, është edhe *i natyrës politike*. Për herë të parë, hapësira e gjerë ilire, që një kohë të gjatë ka nënkuptuar një etnogeografi, pra hapësirë fisesh ilire pavarësisht se dikur disa prej tyre kishin qenë edhe mbretëri të pavarura, por pa ndonjë lidhje të brendshme politike, fiton atributet e një tërësie të pavarur perandorake me identitet të caktuar etnik. Andaj, ishte e natyrshe që në përputhje me këtë koncept, të bëhej edhe organizimi kishtar i Dardanisë në nivelin e një peshkopate. Se ishte kështu, këtë na e dëshmon edhe Koncili i Nikesë i vitit 325, i thirrur nga perandori Konstantin i Madh, kur midis 318 të deleguarve të këshillit, ku pos të tjerësh ishin Hizi nga Kordoba, Nikola nga Smirna si dhe Anastazi, ndodhej edhe peshkopi i Dardanisë, Dacus i nënshkruar si "*Dacus Dardaniae*".<sup>311</sup>

Edhe pse nuk ka të dhëna zyrtare rreth kohës së saktë të themelimit të peshkopatës së Dardanisë, megjithatë, Koncili i Nikesë, bën të ditur se me pjesëmarrjen e peshkopit Dacus, i nënshkruar "*Dacus Dardaniae*", Dardania kishte peshkopatën e vet, së cilës i nënshtrohej edhe Budisi nga Stobi i Maqedonisë. Në koncilin e dytë në Sardikë, në kufirin e dy pjesëve të Perandorisë më 342, peshkopatën e Dardanisë do ta përfaqësojë peshkopi Gazdenci nga Naissus (Nishi i sotëm), i cili merrte pjesë edhe në emër të peshkopëve të Ilirikut. Ai do të bëhet i njohur me propozimin e kanonit 5 rreth kompetencave të Selisë së Shenjtë rreth

<sup>310</sup> Gjini, Gaspër: "*Skopsko-prizrenska biskupija kroz stoljeca*", Zagreb, 1986, faqe 35.

<sup>311</sup> Po aty.

emërimit të peshkopëve, ku do të përkrahet edhe nga mitropoliti i Dardanisë, i cili në dokumentin e Koncilit do të nënshkruhet “*Paregorius a Dardania de Scupis*” (*Progori i Skupit nga Dardania*).<sup>312</sup>

Peshkopata e Dardanisë, si një qendër e rëndësishme kishtare, përmendet edhe me rastin e qëndrimit në këtë provincë të Eustahit, peshkopit të Sebes, i cili me vendimin e koncilit të Kostandinopojës më 360 u detyrua që të migrojë në ato vende. Peshkopi Eustahi ishte ithtar i njohur i arianizmit, gjë që qëndrimi i tij “si i ndëshkuar” në Dardani kishte të bënte edhe me përkrahjen që gëzonte kjo lëvizje në këto anë, dhe për këtë disa nga peshkopët dardanë do të merren në përgjegjësi në koncilin e Kalcedonisë në vitin 451 nën akuzën që i kishin përkrahur “skizëmën”, ku do të arrihet qëndrimi i njohur kundër arianizmit.

Peshkopët si dhe peshkopata e Dardanisë edhe më tutje do të përfshihen në shumë nga çështjet e nxehta kishtare, me të cilat do të merren “dy kishat” me anën e të cilave do të ndikohet edhe jeta politike perandorake. Njëra ndër këto ishte edhe ajo e “*Tri kokave*” (*Tria Capitula*), që do të përfshijë koncilin e Kostandinopojës. Aty ishin të pranishëm që të gjithë peshkopët e Dardanisë: Foka nga Stobi, i cili përfaqësoi kryepeshkopin e Justina Primës, Benenatin, pastaj Sabijan nga Zapora, Projekt nga Naissusi (Nishi i sotëm) dhe Pavli, peshkop i Justiniana Secunda (Ulpianës së mëparshme), të cilët, me përjashtim të Benenatit dhe Fokës, do të nënshkruajnë “*Constitutum*” të papës Virgjilit.

Megjithatë, peshkopata e Dardanisë që nga fillimi ishte e lidhur me kishën e Thessalonikut (Selanikut të sotëm). Ky qytet i madh dhe i rëndësishëm i Perandorisë, do të fitojë edhe më shumë në peshë pas reformave administrative të Dioklecianit dhe të Konstantinit të Madh kur do të caktohet për seli të prefektit të Ilirikut. Kështu, peshkopët e Thessalonikut fitojnë titullin e vikarëve të papës për atë pjesë, që paraqiste një detyrim të madh por edhe të ndjeshëm për ta, kur dihej se aty hiqej kufi midis pjesë lindore dhe perëndimore të Perandorisë, që njëherësh ishte edhe kufij midis kishë së Romës dhe asaj të Kostandinopojës. Vikariatit, si mënyrë e delegimit të pushtetit primar në hapësirën e njëjës ose disa krahinave është i njohur në organizimin kishtar nga fillimi i shekullit V. Vikariatit i parë ishte ai i kishës së Thessalonikut, ndërkohë që vikariatet do të shfaqen edhe te kisha e Arlesit, ajo e Justiniana Primas dhe dy në Spanjë.

Rëndësia që do të fitojë kisha e Dardanisë, gjithsesi ka të bëjë me qëndrimin e saj që të mbështetet kisha e Romës, qëndrim ky i cili në këtë pjesë të Ilirikut përhe-

---

<sup>312</sup> Farlatus D: “*Iliricum Sacrum*”, VIII, 4, cituar sipas Gjini, Gaspër: “*Skopsko-prizenska biskupija kroz stoljeća*”, Zagreb, 1986, faqe

rë ka paraqitur atë baraspeshën e domosdoshme midis Lindjes dhe Perëndimit, pra midis dy pjesëve të Perandorisë, të cilat kanë shkuar rrugëve të ndryshme edhe në saje të divergjencave të njohura kishtare, siç ka të bëjë edhe me veprimet që ndër-mori perandori Justiniani I që kjo krahinë të fitojë peshën e njëjës prej provincave kyçe të Perandorisë në lidhjen e brendshme të Ilirikut si pjesë e Perëndimit.<sup>313</sup>

Ndonëse kjo do t'i kthehet në një barrë të madhe dhe madje dhe edhe do t'i hakmerret, Dardania gjatë kohë së Justinianit I (527-565) nga pikëpamja kishtare, shoqërore dhe politike, bëhet një qendër e rëndësishme e Bizantit.

Kështu, mund të thuhet se në kohën e Justinianit I, i cili vinte nga Dardania, filloi një epokë e suksesshme në jetën kishtare të Dardanisë, ndër më të sukses-shmet që pati ajo gjatë historisë së saj. Perandori, në kuadër të riorganizimit të kishave ilire, themeloi një provincë të pavarur kishtare, së cilës i dha një rol të veçantë në këtë pjesë të Perandorisë. Në atë kohë, nga pikëpamja kishtare, Iliriku Lindor paraqiste një tërësi. Me vendimin e perandorit ajo u nda në dy pjesë, të pavarura dhe me qendra të veçanta. Qendra e pjesës jugore edhe më tutje mbeti në Thessalonik, ndërsa në provincën e sapoformuar, qendër e re e Ilirikut, u bë Prima Justiniana. Perandori, pra kishte qëllim të qartë, që vendlindjen e tij ta ngritë në qendër të re administrative, që u pa me bartjen e qendrës së prefekturës nga Thessaloniku.<sup>314</sup>

Për këtë qëllim, më 14 prill 535 të erës sonë, perandori Justinian, shpalli *Novelën XI* me anën e së cilës ai themelon vikariatit për atë pjesë të Perandorisë. Egzarkati i ri përfshinte këto krahina: Dacia Mediterana, Dacia Ripensis, Mysia Prima, Dardania, Macedonia Secunda, një pjesë e Panonia Secunda që ishte në Baciensicivitate. Kur e gjitha zbërthehet nga aspektet e sotme gjeografike, del se Prima Justiniana futi nën mbikëqyrjen e saj krahinat që përfshijnë Serbinë e sotme, Sremin lindor, Bullgarinë Perëndimore, Maqedoninë Veriore, Dardaninë dhe Malin e Zi. Dhjetë vjet më vonë, me *Novela CXXXI*, perandori nxori dekretin, me të cilin sanksionoi juridikisht gjendjen juridike të Prima Justiniana.<sup>315</sup>

Sipas dekretit të perandorit, krahina e re kishte karakterin e krahinës së pavarur kishtare, duke e zgjeruar deri në maksimum shtrirjen e saj. Peshkopi i Prima Justiniana nuk bartte vetëm titullin e mitropolitit (atë titull e bartte edhe peshkopi i Scupit të rrënuar), pra që paraqiste rangun më të lartë të organizatës kishtare në

---

<sup>313</sup> Emri i vërtetë i perandorit Justinian është *Flavius Petrus Sabbatius Justinianus*, ose *Anicus Julianus Justinianus*. (Shih: Diehle, Ch: "*Justinien et la civilisation byzantine au VI-e siecle*", Paris 1901).

<sup>314</sup> Gjini, Gaspër: "*Skopsko-prizrenska biskupija kroz stoljeća*", Zagreb, 1968, faqe 41.

<sup>315</sup> Po aty, faqe 42.

krahinën e re, por ai bartte edhe titullin e argjipeshkvit, apo të instancës më të lartë në krahinë, autoritetit të të cilit do t'i nënshtrohen disa krahina. Argjipeshkvit të ri i takonte “*summus honore, summa dignitas, summus acerdotium, summum fastigium*” (nderimi më i madh, dinjiteti më i madh, titulli më i madh, shkalla më e madhe).<sup>316</sup>

Këta tituj të lartë nuk ishin vetëm tituj nderi, por kishin edhe forcën e caktuar juridike, sipas së cilës argjipeshkvi i Prima Justiniana drejtonte peshkopët e krahinës së tij, por ai në të njëjtën kohë ishte edhe përfaqësues i drejtpërdrejtë i peshkopit të Romës në këtë pjesë. Nga ajo kohë, as ai e as peshkopët e tij me asgjë nuk do të varen nga peshkopata e Thessalonikut. Po ashtu, argjipeshkvi i Prima Justiniana, si i parë i i dioqezës thërret dhe drejton Këshillat krahinore. Ai merr vendimet përfundimtare rreth të gjitha shqyrtimeve dhe mosmarrëveshjeve që paraqiten midis peshkopëve. Argjipeshkvin e ri e zgjedhin që të gjithë mitropolitët dhe peshkopët në këshillin e përbashkët, pa pasur nevojë që për këtë të bisedohet me peshkopin e Thessalonikut.<sup>317</sup>

Këtu duhet theksuar se gjuha e shkruar dhe të gjitha dekretet e Prima Justiniana kanë qenë latinisht. Shumë nga materialet arkeologjike të kohës, duke përfshirë edhe monogramët e Justinianit nga bazilikat e gjetura janë të shkruara në gjuhën latine, gjë që bën të ditur se edhe gjuha e liturgjisë dhe administrata kish-tare është kryer në këtë gjuhë dhe jo në atë greke. Madje edhe emrat e titullarëve të Prima Justiniana (Catellianus, Benenatus, Johanes e të tjerë) dëshmojnë për sferën gjuhësore latine në këto anë, ku ajo lidhej nga çdo aspekt me Perëndimin.

Edhe pse ende nuk dihet me saktësi ubikacioni (vendi) i Prima Justiniana, nga gjurmimet e kryera në afërsi të Shkupit të sotëm, por edhe në pjesët përreth, veçmas në drejtim të Prishtinës, bëjnë të ditur se ky qytet ndër më të rëndësishmit e Dardanisë, por edhe të pjesës lindore të Ilirikut, është shtrirë në afërsi të Shkupit, në veri në grykën e Lepencit në katundin Zllakuqan. Aty janë gjetur një numër i konsiderueshëm eksponatesh të kohës, ndër të cilat një bazilikë nga koha e krishterimit të hershëm. Meqë ky ubikacioni i Prima Justiniana lidhet me atë të Scupit të moçëm të rrënuar në tërmetin e rëndë të vitit 518, atëherë është fare e arsyeshme që perandori Justinian të ketë vendosur që qytetin ta ketë ndërtuar në afërsi, duke e bartur më në veri, skaj lumit Lepenc, ku edhe më këndeje ka vazhduar të jetë në udhëkryqin e rëndësishëm të rrugëve Naissus-Scupi-Thessaloniki,

---

<sup>316</sup> Po aty, faqe 42.

<sup>317</sup> Po aty, faqe 42.



që kanë lidhur me Egjeun, ndërsa në veri me Singidunumin, ndërsa në perëndim me Adriatikon nëpërmes Ulpianës dhe Lissusit (Lezhës së sotme).

Rrënimi i Scupit të moçëm dhe rindërtimi i Prima Justiniana, që në kohën e Justinianit do të kthehet në kryeqendër të peshkopatës së Ilirikut dhe në një qendër të rëndësishme të Perandorisë, nuk ka ndërprerë vazhdimësinë kishtarë të dioqezës së Scupit e as të jetës kishtarë në Dardani, që kishte një traditë thuajse dyshekullore.<sup>318</sup> Por, krahas Scupit, autorët antikë bëjnë të ditur edhe për dioqezat e tjera të krishtera në Dardani. Hierokleu, krahas Scupit shënon edhe Ulpianën si qendër kishtarë.<sup>319</sup>

Qyteti antik Ulpiana ndodhej në veri të Scupit antik në pjesën qendrorë të Dardanisë. Gjurmime të arkeologjike kanë treguar se qyteti gjendej dhjetë kilometra në jug të Prishtinës, në afërsi të Graçanicës së sotme.

Ulpianën si qytet të rëndësishëm e përmend Shën Anastazi më 343. Qytetin e madh “*urgus splendidis sima*” më 380 do ta vizitojë perandori Teodosi I, i cili nga Sirminiumi shkante për në Thessalonik.<sup>320</sup>

Sipas shënimeve të Jordanit, më 472, Ulpiana u pushtua nga i biri mbreti të Gotëve Tiudimer Teodoriku, i cili pasi pushtoi Naissusin me 3 mijë luftëtarë iu drejtua këtij qyteti, i cili pësoi dëme gjatë kësaj kohe si pjesa më e madhe e vendit kah kaloi ushtria e Teodorikut.

Edhe Ulpiana, si dhe pjesët tjera të Dardanisë, veçmas Scupi pësuan nga tërmeti i madh i vitit 518. Perandori Justinian e rindërtoi Ulpianën dhe ia la emrin Justiniana Secunda.

Në kuptimin kishtar Ulpiana duhet të ketë qenë një qendër e rëndësishme, meqë nga ky vend vijnë edhe martirët e parë dardanë Flor dhe Laur, por Ulpiana njihet edhe si vendlindje e peshkopit monofizit Gergenci, i cili shërbeu si peshkop në Safara të Detit të Zi. Sipas të dhënave kishtarë Ulpiana njihet si peshkopatë në shekullin IV. Në Koncilin e Sardës, më 342 gjenden përfaqësuesit e saj, të cilët, aktet e kuvendit i nënshkruajnë “*Machedonius a Dardania de Ulpiana*”.<sup>321</sup>

Në letrën e sinodit dërguar perandorit Leon më 458 nga peshkopët e Dardanisë Ursili dhe ai i Dalmacisë Maksimi, bëhet e ditur edhe për dy qendra

---

<sup>318</sup> Të dhënat e para rreth dioqezës së parë dardane në Scupi i jep Ptolemej (shih: Ptolomeaeus III 9/4. Bekkerus I), të cilat vërtetohen edhe nga Procopi (shih: Procop, Caesar, *De Aedificiis* IV I) dhe te Hierokles (shih: Hierocles, Synecdemus: *Provincia Dardaniae sub presime, urues 3: Scupom metropolis, Merion “Ulpiana”*, rec. Bekkerus I Bonnae 1844).

<sup>319</sup> Gjini, Gaspër: “*Skopsko-prizrenska biskupija kroz stoljeća*”, Zagreb, 1986, faqe 51.

<sup>320</sup> Po aty, faqe 51.

<sup>321</sup> Më gjerësisht rreth Shën Niketës si autor i himnit të Bizantit shih: Ramadan Sokoli: “16 shekuj”, Eurorilindja, Tiranë, 1996, faqe 29-49.

peshkopate në Dardani: Nentiana dhe Diokleciana,<sup>322</sup> ku do të veprojnë shumë nga misionarët e krishterë, ndër të cilët gjithsesi se i rëndësishëm është Shën Niketa ose Niketë Dardani, i cili bashkë me mikun e tij Paulianin nga Nolea radhitën ndër etërit e kishës.

Për Niketën, më së shumti mësohet nga miku i tij Pauliani, i cili me Shën Niketën ishte dy herë në Romë, më 398 dhe 402. Shën Niketa, la pas veti shumë vepra teologjike si dhe shqyrtime të kësaj natyre, disa prej të cilave janë ruajtur në tërësi e disa si pjesë. Por, nga burimet e lartpërmendura del se Shën Niketa apo Niketë Dardani lindi rreth vitit 340 në Remesiane të Dardanisë. Asokohe kjo qendër e lulëzuar e me seli ipeshkvie përfshihej zyrtarisht brenda kufijve të provincës së Dakisë Mediterane. Për familjen, për moshën e mitur dhe për rininë e Niketës nuk ka asnjë njoftim të përafërt. Ato arrijnë nga moshja e pjekurisë, ashtu siç ka ndodhur edhe me njerëz të tjerë të shquar, të cilëve u njihen vetëm vitet e asaj moshe, sidomos fundi i parabolës së tyre. Për të parën herë Niketë Dardani përmendet më 366 në letrën e Germainit të Serminiumit, ku përfshihet në listën e ipeshkvijve të asaj krahine, me çka kuptohet se Niketë Dardani në moshën 26 vjeçare ishte ipeshkëv i Remisianës.<sup>323</sup>

Krahas veprimtarisë që ia kërkonte detyra ipeshkëvore, Niketë Dardani përqendrohej edhe në punë studimore e krijuese. Ndonëse në aso rrethana nuk ishte e lehtë veprimtaria krijuese e artistëve, Niketë Dardani, i pajisur me prirje letrare dhe muzikore, përpilonte këngë dhe himne e ua mësonte besimtarëve që t'i këndonin bashkërisht.

Ajo që e bën të njohur Shën Niketën ose Niketë Dardanin është edhe himni i njohur "*Te Deum laudamus*" dhe trajtesa "*De psalmodiae bono*". Vepra "*Te Deum laudamus*" është një ndër himnet më të famshme e më të përhapura në mbarë botën. Ky himn lavdërimi, i përhapur në Europën Perëndimore që në vitin 523, ka arritur nëpërmjet dorëshkrimeve të hershme në katër variante me ndryshime të vogla: a) milaneze, b) mozarabike (spanjolle), c) irlandeze dhe ç) galike. Përveç këtyre varianteve njihet një bijim i përfshirë në "*Graduale vaticano*" me melodi të mbartur një kuart më lart.<sup>324</sup>

Përveç himnit "*Te Deum*" Niketë Dardani ka kompozuar edhe këngë të tjera për të cilat mund të mësohet nga të dhëna të tërthorta. Ai shfaqet si autor, edhe

---

<sup>322</sup> Këto peshkopata Farlati do t'i identifikojë si Naissus dhe Duklea (shih: Farlatus, D-Coletus: "*Iliricum Sacrum*", VIII, 5, Venetiis, 1751-1819).

<sup>323</sup> Sokoli, Ramadan: "16 shekuj", Tiranë, 1996, faqe 12.

<sup>324</sup> Sokoli, Ramadan: "16 shekuj", Tiranë, 1996, faqe 46.

pse në disa vende i është mveshur Shën Ambrozit, por që më vonë është vërtetuar se autor i vetëm i himnit është Shën Niketa nga Dardania.<sup>325</sup>

Kjo tregon për rëndësinë e kishës së Dardanisë në kohën e përplasjeve të mëdha kishtare për mbizotërim politik dhe shpirtëror midis Lindjes dhe Perëndimit, por po ashtu flet edhe për përkushtimin e peshkopëve dhe të shenjtërove që drejtpërdrejt t'i kontribuojnë identitetit të saj shpirtëror me krijimet e tyre artistike, siç ishte ai i Shën Niketës në muzikë, por edhe shumë e shumë të tjerëve në fushat tjera të krijimtarisë, veçmas në artet plastike nga ikonat, reliefët e deri te mozaikët monumentalë me të cilët do të stolisen objektet sakrale, por edhe ato publike në gjithë perandorinë.

Këtu, gjithsesi, nuk duhet harruar edhe kontributin e madh në fushën e juridiksionit, siç ishte ai i perandorit Justinian I dhe kodikët e tij të njohur, me të cilët do të sanksionohet e drejta romake, e cila edhe sot e gjithë ditën shërben si model juridik i pazëvendësueshëm.

Meqë, identiteti shpirtëror në Perandorinë Bizantine, ishte pjesë e identitetit shtetëror, pra edhe atij politik, gjithsesi është e udhës të përmenden edhe bartësit që i kanë ndihmuar këtij mbindërtimi si dhe institucionet e caktuara nga dioqezat, peshkopatat, vikariatet e deri te kryeqendra e prefekturës së Ilirisë, siç ishte ajo që u shpall nga perandori Justinian, më 535, me anën e Novelës XI, siç duhet të nxirren në pah edhe realitetet politike dhe shoqërore që prodhoi kjo gjendje, të cilat duhet parë në kuadër të përvijimeve perandorake të kohës rreth të cilave do të bëhet fjalë më vonë.

Natyrisht se këto raporte nuk mund të shpjegohen si duhet e as të pasqyrohen në përputhje me rëndësinë që kishin, jashtë relacioneve zyrtare kishtare, meqë vetëm aty ato mund të konfirmohen si të tilla. Madje, edhe vendimet e perandorit, sado që ai ishte i pavarur, në aspektin fetar, duhej të konfirmoheshin nga kryepeshkopi i Kostandinopojës (po qe se kishin të bënin me provincën lindore) dhe nga Papa, pra Selia e Shenjtë e Romës (po qe se kishin të bëjnë me pjesën që ajo mbikëqyrte). Në këtë aspekt janë me interes dokumentet që kanë të bëjnë me dekretet dhe letrat drejtuar Kishës së Dardanisë si dhe peshkopëve nga ana e papës dhe Selisë së Shenjtë, pastaj nga perandorët si dhe letrat që peshkopët e Dardanisë drejtuar Selisë së Shenjtë dhe vetë perandorit. Sepse, me anën e tyre jo vetëm që kuptohen më mirë raportet midis kishës së Dardanisë dhe Selisë së Shenjtë, por kuptohen edhe ato të perandorëve me vetë këtë kishë dhe titullarët

---

<sup>325</sup> Gjini, Gaspër: "Skopsko-prizrenska biskupija kroz stoljeća", Zagreb 1986, faqe 58.

e saj, që ishte në nivelin më të lartë, me çka mund të tumiret vlerësimi se forcimi dhe ngritja e kishës së Dardanisë në një nivel të tillë nga Justiniani I ishte pjesë e konceptit që Dardania, si dhe gjithë Iliriku, të ktheheshin në faktorë qendrorë të Perandorisë Bizantine, me të cilën do të mbaheshin dy krahët e saj.

Shikuar nga kjo pikëpamje, disa nga letrat e ruajtura që papatet do t'ia dërgojnë peshkopëve të Ilirikut dhe Dardanisë bëjnë të ditur për pozitën e lartë të kësaj kishe si dhe rolin që luajti ajo në shumë nga përvijimet, filluar nga *arianizmi* (bartur nga Koncili i Parë i Nikesë i vitit 325 e deri te ai i treti i Kalcedonisë i vitit 451), pastaj grindjet e ashpra rreth *dyfizitëve* dhe *monozifizmit* e deri te çështja e “*tri kokave*” dhe të ngjashme, ku si do të shihet peshkopët e Dardanisë dhe ata të Ilirikut shfaqen përherë në qendër të këtyre përpëlitjeve. Ata kanë ndikuar edhe në vendimet e koncilëve, duke hapur çështje të cilat do t'i preokupojnë krerët më të lartë të kishave si dhe vetë perandorët. Të kësaj natyre gjithësesi se janë letrat e Papës Celestina I, që më 424 do t'ua drejtojë nëntë peshkopëve, sipas të gjitha gjasave krerë të krahinave kishtarë, ku është edhe ai i kishës së Dardanisë dhe u urdhërohet që t'i nënshtrohen Rufit, peshkopit të Thessalonikut, që ishte vikar i përgjithshëm.<sup>326</sup>

Paraprakisht, me një thirrje të njëjtë peshkopëve të Dardanisë do t'u drejtohet edhe Papa Inocenti I me anën e qarkores “*Magna me gratulatio*”, ku kërkohet qëndrim i prerë kundër heretikëve dhe herezisë, që ishte shfaqur nga veprimet e peshkopit të Naissusit, Bonozi.

Se çështjet e heretikëve do të vazhdojnë edhe më tutje dhe do të shqetësojnë Selinë e Shenjtë, kjo shihet edhe nga letra që papa Gelazi I drejtuar peshkopëve të Dardanisë më 493. Ajo mban titullin “*Ubiprimum*” dhe kërkohet besnikëri ndaj Selisë së Shenjtë dhe mësimëve të saj. Me të njëjtën porosi mund të vlerësohet edhe ajo që i njëjti papë pas një viti, me titullin “*Audientes orthodoxam*”, u drejtohet të gjithë peshkopëve të Dardanisë: “*universis episcopis per Dardaniam sive per Illyricum constitutis*”.

Edhe këtu, Papa Gezali I kërkon që t'u qëndrohet larg “*lajthitjeve të Eutihut*” si dhe të mos mbështetet peshkopi i Thessalonikit, i cili nuk iu ka përgjigjur kërkesës që të gjykohet Akaci.<sup>327</sup>

Papa Gelazi I do t'i drejtojë edhe dy letra kishës së Dardanisë, në të cilat vazhdimisht përkujtohen detyrimet ndaj Selisë së Shenjtë dhe qëndrimeve të saj në raport me çështjet që preokuponin Lindjen dhe Perëndimin në rrethanat e

---

<sup>326</sup> Po aty, faqe 61.

<sup>327</sup> Po aty, faqe 62.

shqetësimeve që sillnin sulmet barbare në lindje si dhe përpjekjet që ato të “zbuteshin” me anën e aleancave të ndryshme me ta, siç do të jenë ato me Gotët, Vizigotët, ose Hunët, që do të kalojnë në çështje të brendshme të Perandorisë, veçmas kur ato do të shfrytëzohen për qërim hesapesh midis rivaliteteve të brendshme.

E të njëjtës natyrë është edhe letra e papës Simah nga viti 512 drejtuar të gjithë peshkopëve, xhakonëve, arhimandrëve dhe krerëve kishtarë në Ilirik, Dardani dhe në të dy Dacitë.

Pas shfaqjes së Prima Justiniana në rangun e vikariatit dhe të kryeqendrës kishtare të provincës së Ilirikut, Selia e Shenjtë disa herë do t’u drejtohet krerëve të kësaj qendre që kishte autoritetin kryesor pas Selisë së Shenjtë. Kështu, papa Gërgurit të Madh, më 592 i drejtohet vikarit të Prima Justiniana me letrën “*Post longas*”, pastaj më 594 do t’i drejtohet me letrën “*Manifest umbonitatis*”. Me letër i njëjti papë i drejtohet vikarit të Dardanisë edhe në vitin 599, ku kërkohej të mos i nënshtrohen kishës së Kostandinopojës, por të respektojnë vendimet e hershme, pra ato që kishte sjellë perandori Justinian I, të cilat edhe më tutje vlenin. Letra e fundit e papë Gërgurit dërguar vikarit të Prima Justiniana është nga viti 602. Në të kërkohet të merren masa për të vënë rregull në mitropolinë e Skodrës pas grindjeve që kishin ndodhur midis mitropolitit Konstanci dhe peshkopit Nemison. Kjo flet për kompetencat e mëdha që kishte Prima Justiniana në gjithë Ilirikun.

Të një rëndësie janë edhe letrat që perandorët ia dërgonin peshkopatës së Dardanisë. Me anën e tyre del në pah niveli i lartë që gëzoi ajo për një kohë të gjatë në hierarkinë shpirtërore dhe atë administrative të Perandorisë. Kështu, letra e parë e kësaj natyre është ajo e perandorit Leon I Augustus, me qëndrime perandorak rreth dy çështjeve: e para ka të bëjë me veprimet krye në vete të peshkopit Timotej Eluri, për të marrë drejtimin e peshkopatës së Aleksandrisë pas vdekjes së peshkopit Protera, me ç’rast shfaqet mospajtimi i tij me këtë veprim dhe kërkohen sanksione adekuate. Dhe, e dyta ka të bëjë me koncilin e Kalcedonisë, kur perandori kërkoi mendimet e të gjithë peshkopëve rreth çështjeve të shtruara aty.<sup>328</sup>

Dy letra në formë dekretesh peshkopatës së Dardanisë do t’i dërgohen edhe nga perandori Justinian I, me të cilat ngritet në pozitën më të lartë si kryeqendër kishtare e Ilirikut. Fjala është për Novelën XI të vitit 535 dhe për Novelën CXXXI të vitit 545, me të cilën asaj i jepej statusi i argjipeshkvisë dhe i vikariatit

---

<sup>328</sup> Po aty, faqe 64.

me të cilin definohet “*secundume aqua edefinita funt a sanctissimo Papa Virgilio*” siç e kishte sanksionuar papa Virgjili.

Përfundimisht relacionet e larta të kishës së Dardanisë me papatin dhe Perandorinë plotësojnë edhe letrat që peshkopët ua dërgojnë atyre. Ato gjithsesi se tejkalojnë çështjet kishtare, siç hapin edhe ato të natyrës shoqërore dhe politike, karakteristike për raportet e njohura dhe të panjohura midis Lindjes dhe Perëndimit.

Këto letra si dhe relacionet midis kishës së Dardanisë dhe të Selisë së Shenjtë në njërin anë dhe ato me perandorët, në tjetrën anë, do të vazhdojnë edhe për dy shekuj, me ç’rast kjo peshkopatë si dhe të tjerat e Ilirikut, me përjashtim të asaj të Durrësit dhe ndonjë tjetre, mbesin në anën e kishës perëndimore, pra të Romës, që do të thotë përcaktim perëndimor edhe në rrethanat e administrimit lindor. Si do të shihet, kjo gjendje jo gjithaq e natyrshme, pra me administrim lindor nën Kostandinopojën dhe me përkatësi kishtare perëndimore nën Romën, mori fund me vendimin arbitrar të perandorit Leoni III, i cili në vitin 733, e shkëputi Ilirikun Lindor dhe shumë krahina të tjera nga kisha e Romës për t’ia nënshtruar juridiksionit të patriarkut të Kostandinopojës.

Përpyekja e Romës që të ruajë juridiksionin e saj nën pushtimin bullgar, të cilët kishin depërtuar në disa krahina të vjetra ilire nuk solli fryte. Kështu, në koncilin VIII në Kostandinopojë (869-870), përkundër kundërshtimeve të legatëve të Papës, u mor vendimi që të gjitha pjesët e Ilirikut, nën pushtimin bullgar, t’i mbeten patriarkatit të Kostandinopojës. Aty për herë të fundit do të përmendet termi “Ilirik”.<sup>329</sup>

Me këtë vendim, pra kur Dardanisë do t’i merret peshkopata dhe kryeqendra e vikariatit që e kishte nga Justiniani I e këndej, njëherësh merr fund ajo që mund të quhet identitet vetëqeverisës me elemente të shtetësisë ilire-dardane me një vazhdimësi gjashtëshekullore (nga viti 284-870). Kjo gjendje e anashkaluar ose edhe e pavërejtur nga historia, filloi me reformat e perandorit Dioklecian me prejardhje ilire, kur promovoi Ilirikun pjesë të veçantë të Perandorisë në Lindje, për të vazhduar me ato të perandorit Konstantini i Madh me prejardhje dardane, për t’u përmbyllur me ato të dardanit Justiniani kur Jusitniana Prima bëhet qendrën e dytë kishtare, pas asaj të Selisë së Shenjtë. Meqë, në rrethanat e hierarkisë perandorake kisha ishte bashkëpjesëtare e pushtetit administrativ dhe politik dhe perandori njëherësh ishte kurorë e pushtetit dykokësh, atëherë mund të thuhet se

---

<sup>329</sup> Shih: Manna, S: “*L’ Ilirico e i suoi problemi*” (Oriente Cristiano, a. XVIII, nr. 4, Palermo, 1978 – 64), cituar sipas Gjini, Gaspër: “*Skoposko-prizrenska biskupija kroz stoljeća*”, Zagreb 1986, faqe 66.

shteti dardan e ka zanafillën e vet në kohën e Justinianit për të vazhduar si i tillë edhe për dy shekuj e gjysmë kur do të shuhet nga Bizanti Lindor dhe pushtuesit Bullgarë.

## DARDANIA, MAQEDONIA DHE BIZANTI

Nëse mund të thuhet se me reformat e perandorit Dioklecian dhe me ato të Konstantinit të Madh koncepti për Ilirinë si etnogeografi, që në kujtesën e Romakëve ishte marrë nga Grekët diku në shekullin IV para erës sonë dhe si i tillë kishte funksionuar deri në shekullin e katër pas erës sonë, pra deri atëherë kur një perandor ilir (Diokleciani) me reformat rrënjësore do t'ia ndryshojë karakterin Perandorisë Romake kur Ilirikun do ta kthejë në provincë kryesore lindore, po ashtu mund të thuhet se do të jetë një perandor tjetër dardan, Justiniani i parë, i cili pjesës qendrore të Ilirikut - Dardanisë, me kthimin e saj në qendër kishtarë të Ilirikut si vikariat të lidhur drejtpërdrejt me Selinë e Shenjtë, do t'ia japë identitetin kishtar dhe, me këtë edhe atë politik dhe administrativ, ndër më të fuqishmit dhe ndër më të rëndësishmit, që si i tillë do të mbetet edhe për tre shekujt e ardhshëm përderisa Bizanti do ta rrënojë me çka do të fillojnë rropatjet e njohura të Perandorisë lindore në luftërat e gjata me vetveten (në radhë të parë me faktorët jokonstituiv Bullgarët dhe Sllavët), por edhe me ato nga jashtë, që do ta çojnë edhe deri te fundi.

Perandori Justiniani I, i cili ia doli që Dardaninë dhe me të Ilirikun, ta kthejë në qendër shpirtërore të pjesës lindore të Perandorisë, këtë e bëri sepse udhëhiqej nga vizioni që Perandorisë së moçme romake t'i kthehej fuqia dhe lavdia e përmasave universale, i duhej edhe fuqia e krishterimit ekumenik, fuqi kjo që kishte gjasa që të promovohet në një hapësirë tepër strategjike, pikërisht aty ku nga lashtësia kishte paraqitur nyjen e lidhjeve botërore dhe jo rastësisht kishte pasur themelet edhe Troja e fuqishme, si një shëmbëllesë e qytetërimit botëror, ku Dardanët, si themelues të saj, për çka flasin shumë burime antike që mbështeten edhe nga ato të legjendave, shfaqen ndër aktorët e rëndësishëm që do të marrin pjesë në zhvillimin dhe mbrojtjen e saj deri në çastet e fundit, prej nga pastaj, mbesin të vetmit që fundin e saj e kthejnë në një vazhdimësi tjetër në kohë dhe në hapësirë, që do të përcillet në drejtim të Epirit dhe prej andej në jug të Italisë, ku fiset dardane (Galabrët, Thunatët, Daunët e të tjerë), pa përjashtuar këtu edhe Etruskët

(Tyrrenët), për të cilët shumë burime antike thonë se po ashtu kaluan nga Azira e Vogël në Itali, themeluan Romën.

Në rrethanat e reja, perandori i fundit romak në fronin e Bizantit, njëherësh sovran i krishterë, i vetëdijshëm për origjinën hyjnore të autoritetit të tij perandorak, bëri çmos që Perandorisë së Romës t'i kthehet famën e dikurshme. Por, jo vetëm atë. Justiniani, ndonëse për një kohë të shkurtër, ia ktheu edhe hapësirën që kishte dhe, mbi të gjitha, idenë e Perandorisë universale, por tash edhe me ndihmën e krishterimit, e tregoi si të mundshme.

Shtrohet pyetja si ia doli kësaj kthese të madhe historike, kur perandoria e vjetër romake edhe një herë shpалosi gjithë fuqinë e saj dhe përjetoi çastet e fundit të madhështisë së vet në pikëpamje politike, ato kulturore e shpirtërore, kthesë kjo që pastaj, në një kah tjetër civilizues, fare të kundërt, do t'ia hapë rrugën mesjetës, pikërisht asaj që në sajë të despotizmit, përçarjeve, intrigave dhe gjithfarë luftërave për pushtet njihet si bizantinizëm, kur një koncept perandorak i përmasave universale u kthye në një politikë të keqe qeverisëse?

Për t'u kuptuar më mirë e gjithë kjo, sigurisht, ndihmojnë vetë rrethanat politike dhe shoqërore, që u krijuan në atë kohën kalimtare prej më shumë se dy shekujsh kur krizat e njohura, siç ishte ajo e sistemit skllavopronar vegjetojnë në kriza të përgjithshme shoqërore perandorake. Atyre krizave nuk do t'u jepet përgjigje e përshtatshme, ndërkohë që nga shekulli i parë pas erës sonë e këndeje, si alternativë, politeizmit do t'i paraqitet monoteizmi i krishterë me formulën e jetës së përshtatshme dhe të barazisë "për të vuajturit", premtim ky që do të joshë shtresat e gjera dhe gjithë ata që në sistemin skllavopronar ndjeheshin të shfrytëzuar dhe shpresonin se padrejtësitë e kësaj bote mund të zhduqeshin me jetën e amshueshme të asaj bote. Kur kësaj i shtohen edhe vështirësitë që do t'i shfaqen Perandorisë në Veri dhe Lindje nga sulmet e barbarëve, fillimisht të Gotëve, Hunëve e më vonë edhe të Sllavëve, atëherë duket më se e qartë pse Perandoria Romake ndodhej para sfidës së dështimit. Dështimi do të mund të shmangej ose të shtyhej disi vetëm me anën e ndryshimit të koncepteve themelore mbi të cilat ishte nisur dhe ngritur, pra që t'u përshtatej rrethanave të kohës siç ishte largimi nga sistemi skllavopronar dhe gjetja e gjuhës së përbashkët me krishterimin në përhapje e sipër që mbështetej mbi triumfin e monoteizmit mbi politeizmin.

Natyrisht se këtij kapërcimi historik do t'i ndihmojnë reformat administrative, politike, shoqërore dhe ato ushtarake të perandorëve me prejardhje ilire dhe dardane: Dioklecianit dhe Konstantinit të Madh, veçmas ato të këtij të fundit, kur do ta pranojë krishterimin si religjion shtetëror të Perandorisë. Por ata nuk do të



jenë në gj endje që ta parandalojnë theqafjen e nisur, ngaqë ishte pengu i së kaluarës që nuk lejonte shkëputje rrënjësore (heqja e rendit skllavopronar do të përcillet me rendin bujkrob), njësoj siç nuk lejonte as krishterimi në luftë tëbrendshme tejet të ashpër për dogmën (arianizmi, ajo e dyfizitëve dhe monofizitëve e të tjera), që koncepti universal i Perandorisë të fitonte edhe atë shpirtëror.

Në kohën e këtyre përpelitjeve të mëdha ishte Justiniani, ai që bëri që Perandorisë së vjetër t'i kthehej fama e dikurshme, duke e restauruar edhe me anën e krishterimit si një mjet i fuqishëm. Edhe pse mund të thuhet se krishterimi te Justiniani gjeti një mbrojtës, por edhe kryetar, megjithatë, Justiniani mbetej në thelb një romak dhe ideja e autonomisë së sferës fetare ishte krejt e huaj për të. Ky qëndrim pasqyrohet më së miri me atë se Justiniani i konsideronte papët dhe patrikët si shërbëtorë të tij. Ashtu siç drejtonte punët e shtetit, drejtonte edhe ato të kishës, duke ndërhyrë personalisht në çdo problem që kishte të bënte me organizimin kishtar, duke ia dhënë të drejtën vetes për të vendosur edhe për çështjet dogmatike e të liturgjisë, duke drejtuar koncile, duke shkruar trakte teologjike dhe himne kishtarë.<sup>330</sup>

Mjafton këtu të përmenden *Novelat* e tij (ajo XI dhe CXXXI) me anën e të cilave së pari shpalli Prima Justiniana (vendlindjen e tij) kryepeshkopatë të Ilirikut dhe pastaj e ngriti edhe në nivelin e vikariatit drejtpërdrejt të lidhur me Selinë e Shenjtë.

Të kësaj natyre janë edhe qëndrimet e tij të njohura rreth arianizmit, monofizmit dhe çështjeve të tjera teologjike, që ngarkonin së shumti jetën kishtarë kur atyre nuk u jepej përgjigje e prerë aty ku ato buronin para se të ktheheshin në çështje politike. Andaj, mund të thuhet se në kuadrin e historisë së marrëdhënieve midis shtetit dhe kishës, epoka e Justinianit përbën momentin e ndikimit më të madh të pushtetit perandorak në jetën kishtarë, dhe asnjë perandor tjetër para apo pas tij, nuk pati një pushtet aq të pakufishëm mbi kishën siç nuk pati perandor si ai i cili u mundua që edhe jeta kishtarë t'i nënshtrohet konceptit të Perandorisë universale.<sup>331</sup>

Edhe pse, si do të shihet, aty edhe do të dështojë, perandori Justinian, tregoi se koncepti universal ishte i mundshëm po qe se edhe kishës do t'i përcaktohen kufijtë e sjelljes, paçka se ajo thirrej në fjalën e “krijuesit” dhe në pushtetin e pakufishëm të tij.

Krahas qëndrimit superior ndaj kishës si dhe problemeve të brendshme të saj të cilat barteshin edhe në jetën shoqërore dhe politike perandorake, Justiniani

---

<sup>330</sup> Ostrogorski, Georg: *“Historia e Perandorisë Bizantine”*, Tiranë, 2002, faqe 47.

fillimisht do të përballtet me dyndjet barbare si dhe vështirësitë që kishin sjellë depërtimet e tyre nga Lindja kur pararendësit e tij (Valensiani e të tjerë), në pamundësi që t'i ndalin ato, jo vetëm që u kishin bërë vend, por ato kishin filluar edhe t'i përdornin për qëllime të caktuara politike. Kështu kishte ndodhur me Gotët, të cilëve pas betejës së Adrianopojës, u ishte lejuar të vendoseshin në Traki e një pjese të tyre edhe në Panoni dhe në Ilirikun Perëndimor, prej nga ata do të vazhdojnë sulmet e tyre kundër Italisë.

Në të vërtetë, kur Justiniani erdhi në pushtet, gjendja në pjesën lindore të Perandorisë, veçmas në kufijtë e saj veriorë dhe ata lindorë, ishte thuajse jashtë çdo mbikëqyrje, ngaqë në njërin anë barbarët, të cilët kishin hyrë thellë në ato pjesë dhe krahas rrënimëve kishin filluar edhe të vendoseshin duke vazhduar të sillleshin jashtë çdo ligji, dhe në tjetrën anë Persët vazhdimisht bënë përpjekje që të përvetësonin krahinat e skajshme në kufi, veçmas ato që kishin filluar ta humbin besimin te Perandoria. Gjendje hiq më e mirë nuk ishte as në perëndim, veçmas në Ilirik, ku Gjermanët kishin filluar të vendoseshin dhe depërtonin në drejtim të Italisë dhe të Spanjës pa ndonjë vështirësi duke vënë pushtetin e tyre jashtë mbikëqyrjes perandorake. Kështu pjesa e dobësuar e Perandorisë Romake tashmë në shumë pjesë kishte filluar të pranojë pushtetin e barbarëve, ndërkohë që Gjermanët ishin kthyer edhe në faktorë të rëndësishëm ushtarakë jo vetëm si trupa të rregullta, por edhe në hierarkinë komanduese.

Edhe përkundër këtyre telasheve të mëdha, të cilat kërcënonin që ta rrënonin Perandorinë në të dy pjesët e saj, veçmas atë perëndimore, perandori romak vazhonte të konsiderohej kreu i *orbis romanes* (botës romake) dhe *ikumenes* (truzullit) të krishterë. Mbi këtë doktrinë edhe viset që dikur kishin bërë pjesë në perandorinë romake, merreshin si zotërim i saj i përjetshëm dhe i pakthyesëm, pavarësisht se atëherë qeveriseshin nga mbretër gjermanë, edhe pse të fundit e pranonin sovranitetin e perandorit romak dhe ajo çka ata ushtronin qe vetëm një pushtet i deleguar prej tij. Andaj, rifitimi i trashëgimisë së Romës ishte një e drejtë natyrore e perandorit romak. Ishte një mision i shenjtë i tij çlirimi i territorit romak nga zgjedha e barbarëve të huaj dhe heretikëve arianë, për t'i kthyer kufijtë e dikurshëm të Perandorisë, një e pandarë dhe e krishterë. Justiniani I (527-565) e vuri politikën e tij në shërbim të këtij misioni.<sup>332</sup>

Me të drejtë thuhet se në përputhje me këtë mision, Justiniani nga Tauresio i Dardanisë filloi të veprojë, pra që të drejtonte shumëçka të politikës perandorake

---

<sup>332</sup> Po aty, faqe 42.

qysh gjatë kohës së sundimit të të ungjit, Justinian I (518-527). Intelektuali me ambicie ushtarake do të ngjitet shpejt në hierarkinë e pushtetit prej nga do të dallohet me ambiciet e tij për të kapur majat e tij, që do t'i jetësojë me vdekjen e Anastasit I kur edhe do të zgjidhet perandor. Dhe, kur do të bëhet perandor Justiniani, nuk do të vihet në krye të fushatave ushtarake, siç pritej, sepse ishte edhe ushtarak, e as nuk do të vihet në krye të punëve të veçanta shtetërore, siç ishte aksioni për kodifikimin juridik, e as që do të shpallë masa administrative, por në të njëjtën kohë do të fillojnë fushatat më të rëndësishme të Perandorisë për t'i qëruar hesapet me barbarët në lindje dhe në veri. Në të njëjtën kohë do të fillojnë punët në kodifikimin juridik, siç do të fillojnë edhe reformat e mëdha administrative me anën e të cilave shtetit do t'ia krijojë shumë nga mundësitë që të veprojnë në përputhje me projektet e tij që ai të jetë mbi të gjitha dhe për të gjitha. Në këtë drejtim perandori Justinian zgjodhi bashkëpunëtorët e tij më të mirë: Balsarin dhe Narsetin, ata që udhëhoqën fushatat e mëdha pushtuese. Pastaj zgjodhi Tribanioni, që drejtonte të gjitha punët rreth kodifikimit juridik siç ishte edhe prefekti i pretoratit, Johani i Kapadokisë, ai që mori masat më të rëndësishme administrative. Por përkundër punës së madhe që bënë bashkëpunëtorët e tij të parë dhe kryesorë, Justiniani që frymëzuesi i të gjitha ndërmarrjeve të mëdha të epokës së tij. Aty gjithsesi se bëjnë pjesë edhe ato që lidhen edhe me modernizimin e qyteteve, fortifikimin e pjesëve vitale të Perandorisë, siç ishte Iliriku dhe Dardania, ku ai ndërtoi kështjella madhështore (46 nga Naissuis deri në Skup) dhe ndërtoi kisha të shumta, sidomos në Ilirik dhe në Dardani. Kështu, politika e gjithëmbarshme e restaurimit e ndjekur nga Justiniani ishte shprehje më madhështore e kësaj aspirote, sado që ajo nuk pati jetë të gjatë dhe sado që dështimi i saj pati pasoja të rënda për Perandorinë.<sup>333</sup>

Në luftë për të rikthyer fuqinë e Perandorisë dhe për ta bërë atë edhe më të madhe, Justiniani drejtoi komandantët e tij të fuqishëm në Afrikë dhe në pjesën perëndimore të Europës, për t'i qëruar hesapet me Vandalët, një popull që kishte vënë nën mbikëqyrje Veriun afrikan dhe qysh nga viti 468 kur kishte mundur ushtrinë perandorake shfaqej i pavarur. Belisari zbarkoi në Afrikë në vitin 533 me trembëdhjetëmijë ushtarë, në afërsi të Decimit e të Trakarikut, theu keq ushtrinë vandale. Aty zuri rob edhe mbretin e tyre, Genserik, i cili iu nënshtrua.<sup>334</sup> Me këtë rast luftime të ashpra, Belisari pati edhe me disa fise të tjera mauritane, të cilat për shumë vjet e kishin kundërshtar sundimin e Bizantit.

<sup>333</sup> Kulakovskij: "Istorija", II, 93.

<sup>334</sup> Schmid, L: "Geschichte de Wandalen", faqe 125.

Në të njëjtën kohë Belisarit iu desh të zhvillojë luftime dhe kundër Ostrogotëve, me ç'rast armata bizantine shënoi fitore të njëpasnjëshme në Sicili, të cilën e pushtoi. Prej andej, nga Napoli, iu drejtua Romës, ku ia doli, që pas një rrethimi bukur të gjatë, ta zë rob mbretin ostrogot, Vitige dhe e dërgoi në Kostandinopojë (540). Me këtë rast duhet thënë se një pjesë e madhe e Ilirikut për gjysmë shekulli ishte nën pushtimin e Gotëve. Ata ishin lejuar qysh në vitin 376 të kalonin Danubin dhe kjo bëhej që ata të venin lehtë depërtimit të Hunëve. Por, si u pa “diga” gote nuk bëri punë. Sepse, nën udhëheqjen e Atilës “kamxhikut të Perëndisë”, ata e kaluan Danubin dhe në vitet 441-442 shkretuan një pjesë të mirë të Ilirikut. Gjatë sulmeve të tyre shkatërruan shtatëdhjetë qytete dhe e detyruan Perandorinë e Lindjes t’u paguante haraç të rëndë, përveç largimit nga lugina e Danubit. Më 447 Atila shkretoi edhe një herë Ilirikun dhe Dardaninë, duke depërtuar deri në Greqi.<sup>335</sup>

Ndryshe nga Hunët, Gotët erdhën që të pushtonin vendin dhe të vendoseshin në të. Ata u futën në ushtri dhe me shpalljen e Teodorikut mbret të tyre, fituan të drejtën që të bëheshin pjesë e Perandorisë. Natyrisht, se me “tretmanin e ri” ata u përdorën për qëllime të brendshme në rivalitete midis Lindjes dhe Perëndimit. Kështu, perandori Zeno shtyri Teodorikun që të hidhej kundër Italisë. Me një ushtri prej 200 mijë vetash Teodoriku, në vitin 489 i zgjeroi zotimet e tij në Ilirik dhe në provincat e tjera në Veri e në Lindje si edhe në Itali e Gali. Ushtria romake ndaloi përkohësisht shtrirjen e Gotëve, por jo edhe fundin e tyre. Kur dukej se kishin vendosur që t’u bindeshin urdhrave perandorake, të udhëhequr nga Totilo, ata ngritën krye dhe nisën të korrin suksese të njëpasnjëshme kundër Romakëve. Dhe, po mos të ishte Narseti, një tjetër ushtarak i fuqishëm i Justinianit, i cili u dërgua në Itali dhe ia doli t’i nënshtrojë ata, por këtë herë ndëshkimi ishte shumë i rëndë, prej nga ata nuk ia dolën të marrin veten. Kështu, mbretëria e Ostrogotëve ra në vitin 552 dhe Gotët u zhduken fare nga historia.<sup>336</sup>

Pra, pas njëzet vitesh në këtë pjesë u bë rivendosja e pushtetit të vjetër. Me këtë rast aristokracia latifondiste rifitoi pronat nga të cilat e kishin zhveshur Ostrogotët. Megjithatë, mbetej edhe Spanja që t’u shkëputej Gjermanikëve. Aty ishin Visigotët, të cilëve, pak nga pak iu morën shumë nga pjesët e gadishullit Iberik me çka pas fitores ndaj Ostrogotëve në Itali, Mesdheu përsëri u bë një liqen i Perandorisë.<sup>337</sup>

---

<sup>335</sup> Jacques, Edvin: “Shqiptarët”, Tiranë, 2002, faqe 171.

<sup>336</sup> Po aty, faqe 171.

<sup>337</sup> Ostrogorsi, Georg: “Historia e Perandorisë Bizantine”, Tiranë, faqe 43.

Koha e sukseseve në Afrikë dhe në Perëndim kundër Vandalëve, Gotëve, Vizigotëve dhe të tjerëve, nuk do të përsëritet në Lindje. Kështu, shqetësimi kryesor nisi të vinte nga Persia, e cila gjithnjë e më shumë po depëronte në pjesët e skajshme të Perandorisë. Edhe pse Justiniani më 532 kishte lidhur një paqe me mbretin pers Khusrav I Anoshakravan (531-579), e cila do t'i kushtojë shumë, meqë u detyrua t'i paguante tribute Perandorisë Perse, Khusrava më 540 shkeli marrëveshjen duke u lëshuar në Siri, hyri në Antioke ku ushtria e tij bëri dëme të mëdha. Persët vepruan njëjtë edhe në veri kur hynë në Armeni, Hiberi dhe pushtuan krahinën e Lazikës në Detin e Zi.<sup>338</sup> Përparimet e mëtejshme të Persëve u ndalën disi me anën e një paqeje të re me një afat prej gjysmë shekulli si dhe me shtimin etributeve, gjë që kjo bëri që Persia të rrisë gjithnjë e më shumë fuqinë e saj në Lindje.

Paqja e arritur me Persët, edhe pse do t'i kushtojë shumë Justinianit, nuk e ndaloi që të depërtojë kah Kina nëpër një shteg duke i kaluar anash territorin persian nëpërmes bazave bizantine të Kersonës e Bosforit drejt Gadishullit të Krimisë e Lazikës në Kaukaz. Kina ishte e rëndësishme për Bizantin, sepse ajo ishte një treg i madh, prej nga merrte dhe jepte shumë. Interesi, këtu, përqendrohej rreth mëndafshit kinez. E ashtuquajtura “luftë për sigurimin e mëndafshit” për herë të parë e vuri në aleancë Bizantin me Turqit, të cilët asokohe shtriheshin deri në pjesën veriore të Kaukazit dhe, që ashtu si Bizantinët, ishin në armiqësi me Persët për çështje të tregtisë së mëndafshit.

Vizioni i Justinianit për një perandori bizantine të përmasave botërore, krahas atyre në drejtim të Azisë Qendrore e deri në Kinë, që shkonin nëpërmes Detit të Zi dhe Kaukazit, do ta çojë atë edhe në drejtim të Indisë, ku bëri përpjekje të mëdha t'i afrohej sa më tepër. Tregjet e reja për të, prej nga siguroheshin lëndët e para, siç ishte mëndafshi kinez dhe prodhimet e tjera në Lindje, Perandorisë i sillnin zhvillim të madh brenda siç ia shtonin mundësitë që pastaj prodhimet e saj t'i hidhte nëpër tregjet botërore. Kështu, ajo shtonte të ardhurat e veta, të cilat i duheshin synimeve të tilla.

Krahas sukseseve të mëdha që arriti duke rikthyer hapësirat që Perandoria kishte humbur dhe duke ia shtuar edhe shumë të tjera, vepra më e madhe dhe më e qëndrueshme e epokës së Justinianit padyshim mbetet kodifikimi i të drejtës romake. Edhe këtu, ai pati dorë të djathtë bashkëpunëtorin e tij të ngushtë Tribanionin, i cili bëri që vepra e Justinianit të përfundojë sa më shpejt dhe të jetësa më e kom-

---

<sup>338</sup> Po aty, faqe 43.

pletuara. Kështu, e gjithë vepra, e quajtur *Codex Justinianus* u botua më 529, në mënyrë që pas katër vitesh të botohet e plotë. Krahas *Codexit dhe Digestit* (përmbledhje me sentencat e pafundme të juristëve Romakë), u hartua edhe *Institutiones*, i paraparë si një doracak për studimin e të drejtës, ku përfshihen shkëputje nga dy veprat kryesore. Kështu, i gjithë *Corpusi uris civilis* plotësohet nga përmbledhja *Novellae*, që ishin ligje të dala pas botimit *Codex-it, Digestit dhe Institutiones*, të cilat u botuan në latinisht, kurse pjesa më madhe e *Novella* në greqisht.

Kodifikimi i së drejtës romake i shërbeu si bazë juridike e njësuar shtetit të centralizuar bizantin, tipar i së cilit është theksimi i absolutizmit perandorak. Por, kodi i Justinianit, po ashtu, u shpalli lirinë dhe barazinë e të gjithë njerëzve, pa marrë parasysh si dhe sa zbatohet një parim i tillë.

Si u tha edhe më lart, Perandoria e Justinianit, nuk ishte në gjendje t'i bënte ballë testit të kohës. Ajo shkëlqeu një kohë dhe mund të vazhdonte të ishte e tillë vetëm për sa do ta kishte në krye atë, i cili mund të pajtonte një të kaluar të lavdishme, e cila nuk mund të përsëritej dhe një të ardhme, e cila nuk mund të ishte e qëndrueshme pse i mungonin perandorët me vizion siç ishte Justiniani.

Kështu pas vdekjes së Justinianit, Perandorisë filluan t'i vinin tronditjet dhe të rënat prej nga kishte nisur rikthimin e saj, pra në Itali dhe në Afrikë. Në Itali më 568 sulmuan Longobardët, të cilët pushtuan një pjesë të vendit. Në Spanjë prapë dolën në skenë Visigotët, të cilët më 572 morën Kordovën dhe pas pak pjesët më të mëdha të vendit. Në Afrikë, krahas fiseve mauritiane, u shfaqën Arabët me sulmet e tyre të fuqishme dhe të pandalshme drejt Veriut të saj, duke paralajmëruar përfshirjen e tyre të shpejtë në zhvillimet që do t'i japin ngjyrim të veçantë qytetërimin botëror. Kështu, qendra e gravitetit të politikës bizantine u zhvendos përsëri drejt Lindjes, ku edhe do të mbetet edhe për shumë kohë në vorbullën e shumë e shumë përpëlitjeve dështuese deri edhe sa do t'i vijë fundi i njohur.<sup>339</sup>

Rënia e fuqisë perandorake të cilën asaj ia kishte rikthyer Justiniani, nuk ishte vetëm humbje e diçkaje që mund të rikthehej në rrethana të caktuara. Përkundrazi, kjo humbje paraqiste një etapë themelore në shndërrimin e strukturës së vjetër shtetërore të periudhës së fundit romake në një sistem të ri, atë të Perandorisë bizantine mesjetare, me çka praktikisht, në skenën historike shfaqet ajo që njihet si M e s j e t ë.

Shfaqja e asaj që do të quhet mesjetë, po ashtu lidhet me pasardhësit e Justinianit dhe përpjekjet e tyre që ta ripërtërijë perandorinë perëndimore me vitali-

---

<sup>339</sup> Po aty, faqe 49.

tetin lindor, por duke ndërlidhur qeverisjen politike me atë ushtarake. Kjo do t'i hapë rrugën militarizimit të pushtetit perandorak, që do të çojë deri te një krizë e re qeverisjes me shqetësime dhe trazira të mëdha, të cilat do të prodhojnë edhe tirani siç ishte ajo e perandorit Foka në vitin 605 kur do të përmbysset nga ai i Heraklit, i cili më 5 tetor të atij viti, pas ngjarjeve të përgjakshme do të kuro-rëzohet perandor nga patriku i Kostandinopojës me çka merr fund njëherë e përgjithmonë faza e fundit e Perandorisë Romake dhe mbyllet ajo që është quajtur periudhë romake e vonë apo bizantine e hershme.<sup>340</sup>

Ishte pikërisht krahu i tij i djathtë, Maurici, i cili pas dy perandorëve që erdhën pas vdekjes së Justinianit, Justin II dhe Tiber Konstantinit (578-582), do të vijë në fronin perandorak dhe për njëzet vjetët e ardhshme, sa do ta mbajë atë (582-602), ia doli që Perandorinë, pas shumë e shumë çrregullimesh, ta forcojë nga brenda dhe njëherësh ta lirojë nga kërcënimet e vazhdueshme të Persëve, me të cilët do të zhvillojë luftëra të gjata, të cilat do t'ia dalë t'i përmbyllë me sukses në saje të angazhimit të të gjithë fuqive të brendshme të Perandorisë, me ç'rast ai do të lidhë një traktat paqeje afatgjatë me Persët, me të cilin një pjesë e madhe e Armenisë Persiane i kalonte Perandorisë Bizantine.

Fitoret e Mauricit në Lindje me Persët dhe stabilizimi i Perandorisë nga brenda, nuk mund të thuhet se shkuan në dëm të pjesës perëndimore të Perandorisë. Ai, përkundrazi, bëri përpjekje të mëdha e të pareshtura që të ruhen zotimet e saj nga koha e Justinianit, veçmas në Afrikë dhe në pjesën e Ravenës, ku shfaqeshin Longobardët me pretendimet e tyre të njohura. Por, për dallim nga Justiniani, i cili shtrirjen e pushtetit perandorak e shihte si një çështje civilizuese dhe përpiquej që të ishte i tillë kudo, Maurici iu kthye organizimit të rreptë ushtarak në krahinat perëndimore. Kështu, krijoi *ekzarkatet* e Ravenës dhe atë të Kartagjenës<sup>341</sup>, njëformë e dinastive ushtarake, të cilat ishin në gjendje të vetë-mbroheshin. Këto vikariate iu nënshtruan ekzarkëve me çka *u inauguroi periudha e militarizimit të administratës bizantine* dhe paralajmëroi sistemin e ardhshëm të *themave*, mbi të cilin, siç dihet, do të shtrihet mbikëqyrja e re dhe e drejtpërdrejtë e pjesëve të ndryshme të Perandorisë nga qendra si dhe drejtimi i tyre në përputhje me interesat e saj.

*Militarizimi i Perandorisë*, edhe pse dukej se solli stabilizim, së paku në disa pjesë, megjithatë, nuk ishte në gjendje që asaj t'ia kthejë pretendimet që të mbetej

---

<sup>340</sup> Schevill, Ferdinand: "Iliriku – historia dhe qytetërimi", Tiranë, 2002, faqe 56.

<sup>341</sup> Hekzarkati i Ravenës përmendet për herë të parë më 584, ndërsa ai i Kartagjenës takohet për herë të parë më 591. Më gjerësisht shih: Diehl, *Exarchat*, 6; Hartman: "Byzantinische Verwaltung", 9 e vijim; Gelzer: "Themvenverfassung", 6 e vijim.

në kursin e njohur të Justinianit si perandori botërore. Dyndjet e Sllavëve në njërën anë si dhe vlimet e brendshme kundër qeverisjes absolute hapën frontet e brendshme, që u pasqyruan me një luftë të ashpër midis “*të kaltërve*” dhe “*të gjelbërve*” (rryma politike midis *demosit* dhe *deposit*), të cilat çuan te dobësimi i autoritetit të pushtetit. Nëse kësaj i shtohen edhe pakënaqësitë që përfshinë ushtrinë (mungesa e pagave, demoralizimi nga fushatat e gjata në veri kundër Gotëve dhe Sllavëve, që ishin gjithnjë e më këmbëngulës për të depërtuar në pjesën lindore), atëherë gjendja sa vinte e bëhej e pjekur për një reagim të ushtrisë. Nuk do të vonojë dhe do të vijë nga pjesa e Danubit, kur një nënoficer gjysmë-barbar i quajtur Foka, në krye të ushtarëve të rebeluar marshoi në Kostandinopojë. Kjo i dha shkas një kryengritjeje të madhe në vetë kryeqytetin bizantin që për pasojë pati rrëzimin nga froni të Mauricit dhe shpalljen e Fokës perandor.

Ardhja e oficerit gjysmë-barbar në fronin perandorak, që ishte shprehje e një puçi të parë ushtarak, hapi kapitullin e përgjakshëm të qeverisjes bizantine, që pasoi me terror të pakontrolluar, komplete të brendshme dhe intriga ndër më të rëndat. Gjithë kësaj i parapriu terrori ndaj perandorit Maurici, që pasi që u shfronësua, u ther mizorisht dhe ashtu në frymën e fundit u tërhoq zvarrë për të parë masakrën e të bijve të tij. Këto ekzekutime u pasuan nga vrasje në masë me ç’rast terrori qëlloi kryesisht familjet e shquara, të cilat iu kthyen qëndresës me anën e kompleteve të ndryshme, që për pasojë patën masakrat e reja, të cilat bëheshin të drejtuara nga “lozhe” të caktuara.<sup>342</sup>

Në këtë përpëlitse të përgjakshme, kur do ta humbë përkrahjen e brendshme, veçmas nga aristokracia, e cila iu kthye kundër pse futi edhe aparatit ushtarak në terrorin shtetëror duke e bërë atë në një faktor vendimtar force, bëhet e ditur se perandori Foka kërkoi dhe e gjeti përkrahjen e Romës, kartë kjo, që si do të shihet, do të jetë njësoj e dëmshme dhe madje fatale për të dy palët, veçmas për Selinë e Shenjtë, e cila pastaj përfundimisht do ta humbë ndikimin në Lindje jo vetëm në planin shpirtëror, por edhe në atë administrativ dhe kulturor. Ngaqë pas rënies së tiranit Foka kisha e Kostandinopojës jo vetëm që do të bëhet zotëruese e plotë e Lindjes, por ajo do ta heqë nga përdorimi zyrtar gjuhën latine dhe nga ajo e liturgjisë me çka fillon koha e greqizimit të kishës ortodokse në gjithë perandorinë lindore.

Në të vërtetë, perandori dinak, kthimin nga Roma e bëri duke i dërguar një edikt papës Bonifac III më 607, kur ai i njëjti kishës apostolike të Shën Petrit

---

<sup>342</sup> Ostrogorski, Georg: “*Historia e Perandorisë Bizantine*”, Tiranë, 2002, faqe 51.



primatin mbi të gjitha kishat, me çka shkeli një edikt të para një shekulli kur patriarkët e Kostandinopojës mbanin titullin “patriark ekumenik”.<sup>343</sup>

Përkrahja e Romës dhe pushteti që i dha asaj, pos lavdeve që iu thurën tiranit të Bizantit në Perëndim, nuk i sollën tjetër, pos humbjes së besimit të mëtutjeshëm në Kostandinopojë, që zuri të shprehej me format e ndryshme të luftës civile, të cilat u bënë të pashmangshme kur politika e tij ortodokse kishtare degeneroi në persekutime të përgjakshme të monofizitëve dhe të judëve.

Në këto rrethana të dobësimit të brendshëm, sërish u shfaq rreziku nga jashtë. Ai vinte nga Persët, të cilët hetuan çastin e duhur që t’i rikthenin ato që dikur ua kishte marrë perandori Maurici. Mbreti i Persisë, Kursravi II, pikërisht ai që Maurici dikur e kishte sjellë në pushtet, por që t’i mbetej besnik paqes së lidhur me detyrim, sulmoi Bizantin dhe më 605 pushtoi kështjellën e Darës. Nuk u ndal me aq, por vazhdoi edhe më këndeje në Azi të Vogël me ç’rast pushtoi Cezarenë dhe iu afrua Kalcedonit.

Kur Perandoria ishte buzë përmbytjes, shpëtimi do t’i vijë nga periferia. Herakli, ekzark i Kartagjenës ngriti krye kundër regjimit terrorist të Fokës. Me të u bashkua edhe Egjipti. Herakli dërgoi në Kostandinopojë në krye të një flote të fuqishme, djalin e tij, që quhej gjithashtu Heraklit. Aty u prit më entuziazëm dhe më 3 tetor regjimi terrorist i Fokës u përmbys, ndërsa tirani u dogj publikisht në hipodrom. Pas dy ditësh Herakli u kurorëzua perandor nga patriku i Kostandinopojës.

Ky ishte momenti i vërtetë i fillimit të historisë bizantine, pra i historisë së Perandorisë greke mesjetare dhe i greqizimit të Bizantit.<sup>344</sup>

Faktorët që sollën te ky ndryshim historik rëndom kërkohen nga jashtë (sulmet Gote, Avare, Hune, Sllave dhe të tjera në Veri dhe Lindje), gjë që atyre nuk mund t’u mohohet roli që në disa raste ka qenë edhe vendimtar, por me këtë rast sikur nënvlerësohen ose zbuten fare të brendshmit, në radhë të parë ai kishtar dhe ushtarak, të cilët rrënjësisht do t’ia ndryshojnë konceptin idesë së Justinianit rreth Perandorisë universale, pra asaj botërore me krishterimin që do t’i nënshtrohej perandorit dhe për qendër shpirtërore do ta kishte Selinë e Shenjtë, pra Perëndimin.

Pa mëdyshje se faktorët e jashtëm, sulmet gote, avare, hune dhe sllave, do të dobësojnë fuqinë mbrojtëse të Perandorisë, siç do të jenë edhe krizat e tjera që do të prodhojnë reforma administrative dhe ekonomike, por ato do të shfrytëzohen nga kisha lindore dhe kasta e re ushtarake, që solli në pushtet tiranin Foka, për

---

<sup>343</sup> Më gjerësisht shih: Gelzer, H: “*Der Streit ber den Titel des ökumenischen Patriarchen*”; Gaspar, E: „*Geschichte des Papsttums*“, 1933, cit. 364,452; Haller, J: “*Das Papsttum*“.

<sup>344</sup> Ostrogorski, Georg: “*Historia e Perandorisë Bizantine*”, Tiranë, 2002, faqe 52.

qëllimet e veta, për t'i dhënë fund njëherë e mirë ndikimit të kishës së Romës në Lindje, siç do të ndodhë pas ardhjes së Heraklit në fronin perandorak, në vitin 605, dhe po ashtu, me ndihmën e *faktorit kishtar-ushtarak*, për t'ia hapur rrugën greqizimit të Bizantit. Ishte pra ky fillimi i një aleance në mes të kishës dhe armatës, e cila në ngjarjet e ardhshme luajti një rol të rëndësishëm, ngaqë kjo lidhje do ta militarizojë kishën, ndërsa veprimet e shpeshta puçiste të ushtarakëve do t'i bekojë me frymën kishtare.

Ç'është e vërteta vetë ardhja e Heraklit në Kostandinopojë në krye të një flote ushtarake, e cila ndërhyri për ta shpëtuar atë nga kolapsi ku ndodhej ishte pjesë e një marrëveshjeje midis kishës së Kostandinopojës dhe ekzarkatit të Kartagenës, Heraklit, për ta hequr tiranin Foka nga fronti e bashkë me të për ta shfuqizuar edhe ediktin e tij të vitit 607 me anën e të cilit Selisë së Shenjtë i njihej primati kishtar në gjithë Perandorinë. Kështu edhe ndodhi. Kjo u pa më së miri me kurorëzimin e Heraklit perandor nën bekimin e peshkopit të Kostandinopojës, i pari i një natyre të tillë prej nga i pari i kishës ortodokse do të kthehet edhe në zëvendës të perandorit.

Gjithnjë duke shfrytëzuar shkasat që i vinin nga kërcënimi avar, hun dhe sllav në viset rreth Danubit, Herakli i mbështetur fuqishëm nga kisha e Kostandinopojës vazhdoi të rrënojë sistemin administrativ të qeverisjes së brendshme të Perandorisë, që ishte ndjekur nga perandorët që vinin nga Iliriku: Konstantini i Madh, Justini dhe Justiniani, të cilët ia vunë themelet Bizantit pikërisht duke u mbështetur te koncepti i Perandorisë Romake, të cilit i jepej edhe fuqia e krishterimit jo në kuptimin e mbizotërimit ndaj tij, por të bashkëpjesëtarit të tij që perandori të jetë njëherësh edhe me bekimin shpirtëror, siç do të veprohet nga Konstantini i Madhe dhe veçmas nga Justiniani I në mënyrë që të bëjë për vete edhe masat e gjera që u besonin premtimeve të krishterimit rreth barazisë sociale. Pra, Herakli, shqitjen e parë nga koncepti i perandorëve bizantinë që vinin nga Perëndimi dhe krishterimin e shfrytëzonin për nevoja politike, do ta bëjë duke filluar me ndryshime të thella nga struktura e ushtrisë dhe e administratës provinciale të shtetit bizantin mesjetar, i cili në kohën e perandorit Mauric ishte ndarë në ekzarkate. Kështu, mbi bazën e ekzarkateve, siç ishte ai i Kartagenës dhe Ravenës, ai ngriti sistemin e *themave*,<sup>345</sup> me ç'rast territori i Azisë së Vogël ende pa u shkelur nga Persët, u nda në qarqe administrative me një karakter të qartë ushtarak. Në

---

<sup>345</sup> Fjala "*themë*" tregon një trupë ushtarake e më tej u përdor për të shënuar distriktet e reja ushtarake me të cilat sigurohej pushteti i brendshëm. Në fakt ato nuk përfaqësonin vetëm njësi administrative, por edhe territore të kolonizuara nga trupat. Ushtarakëve u jepej një fond toke i trashëgueshëm, që në burimet e mëvonshme quhet "pronë ushtarake". Nga koha e Heraklitit lindën temat e Opsikanëve, të Armenëve dhe të Anatoëve. E asaj kohe është edhe thema detare e Karabisianëve, në krahun jugor të bregdetit të Azisë së Vogël.

krye të *themavedo* të vendosen strategët ushtarakë, të cilët kishin kompetenca të mëdha, meqë nën mbikëqyrjen e tyre përfshiheshin më shumë se një nga provinca e vjetra.

Ky sistem, i cili përfshinte edhe ushtritë vendore, ato të bujqve që quheshin “*stratioti*”, bëri që t’i ndryshohet forma qeverisjes vendore, e cila me shfaqjen e *themave* dhe të *strategëve* ushtarakë në krye të tyre, humbte atë të prefekturave, që kishin qenë nga koha e Dioklecianit e këndej. Ishin tash *strategët* dhe *kishtarët* përkrah tyre, ata që kishin fituar gjithë fuqinë e pushtetit vendor, i cili, si do të shihet, së paku për një kohë do të tregohet i suksesshëm. Dhe ky sukses, do të pasqyrohet me forcën që fitoi Herakli për të filluar një fushatë ushtarake kundër Persëve, e mundësuar pasi që ai paraprakisht të lidhte paqe me Avarët (619), të cilëve u detyrua t’u paguante njëtribut të rëndë, të domosdoshëm që ata t’i mbannte sa më larg përderisa do të kishte punë me Persët.

Natyrisht se pas katër vitesh Herakli mundi të fillonte luftën kundër Persëve, të cilën, pas humbjeve nismëtare, do ta fitojë, me ç’rast do të hyjë edhe në rezidencës së Ardashirit, të parit të Sasanidëve, dhe një ndër qendrat më të rëndësishme fetare të Persianëve. Me këtë rast Khusravi u detyrua të braktiste qytetin, që ra në duar të Bizantinëve. Tempulli i zjarrit të Zoratustrës, tempulli më i rëndësishëm i qytetit, u shkatërrua në shenjë hakmarrjeje për plaçkitjen e Jerusalemit.<sup>346</sup>

Fushata e suksesshme e Heraklit në Persi, u pasua nga një kundërsulm i papritur pers më 626, kur prijësi i tyre, Shahbaraz, përshkoi Azinë e Vogël, pushtoi Kalcedonin dhe u shfaq në Bosfor. Në të njëjtën kohë, Kostandinopojës do t’i afrohen edhe hordhitë e shumta të Avarëve, të cilave u ishin bashkuar edhe Sllavë, Bullgarë e Gepidë. Në korrik rrethua qytetin dhe deri te portat kryesore. Beteja u vendos në det, kur flota e fortë bizantine theu lundrat sllave, të pamësuar me një ballafaqim të tillë, nuk ishin në gjendje për një luftë të organizuar. Kjo bëri që forcat tokësore të Avarëve të tërhiqen në panik, gjë që ndikoi që edhe forcat perse të braktisin Kalcedoninë në drejtim të Sirisë. I vëllai, Shahini, u mund keqas nga i vëllai i perandorit, Teodori.<sup>347</sup>

Dështimi avar-sllavo-pers para mureve të Kostandinopojës i dha krahë Heraklit, i cili hetoi çastin që të bënte një demonstrim tjetër ushtarak ndaj Persisë, së cilës do t’i jepet një grusht i rëndë, kur në vitin 628 u pushtua Khursavi dhe Destagerdi. Shfronësimi i Khursavit pak më vonë si dhe hipja e djalit të tij, Kavadh Shiroe në fron, që do të mbikëqyrej nga Herakli, ia ktheu që të gjitha

<sup>346</sup> Ostrogorski, Georg: “*Historia e Perandorisë Bizantine*”, Tiranë, 2002, faqe 69.

<sup>347</sup> Po aty, faqe 70.

territoret Perandorisë: Armeninë, Mesopotaminë romake, Sirinë, Palestinën dhe Egjiptin. Kjo bëri që në pranverën e vitit 680 Herakli të shkojë në Jeruzalem dhe të rikthejë Kryqin e Shenjtë, të rrembyer para sa vitesh nga Persianët. Kjo ceremoni solemne sanksionoi përfundimin me fitore të së parës betejë të madhe fetare të erës së krishterë.<sup>348</sup>

Edhe pse fitoret e rëndësishme ushtarake të Heraklit në Lindje nuk do të zgjasin shumë, pasi që ato, si do të shihet, do të anulohen shpejt nga sulmet arabe, megjithatë epoka e Heraklit në historinë e Bizantit paraqet një kthesë jo vetëm në jetën politike por edhe atë kulturore. Sepse, me Heraklin *mbyllet faza romake dhe hapet ajo bizantine* në kuptimin e vërtetë të fjalës. Greqizimi i plotë dhe klerikalizimi i fuqishëm i gjithë jetës publike, i japin një fizionomi të re shtetit në tërësinë e tij.<sup>349</sup>

Krahas kësaj, perandorit Herakli i atribuohet edhe një “meritë” tjetër e madhe që do t’ia ndryshojë pamjen jetës së brendshme perandorake. Fjala është për lejimin e vendosjes së Sllavëve në Ilirik, fise këto barbare nga Karpatet, që kishin kohë që me dyndjet e tyre drejt Perëndimit po i kërcënoheshin qytetërimit të tij, por që “pranimi” i tyre me hesapin që ata në këtë mënyrë “të zbuten” në dobi të Perandorisë, do të bëhet në dëm të faktorëve të saj kryesorë etnikë dhe shoqërorë, Ilirëve dhe Dardanëve, të cilët kishin merita të mëdha për themelimin dhe ngritjen e Bizantit dhe sjelljen e tij deri te një fuqi e madhe në Lindje. Perandorët ilirë dhe dardanë: Diokleciani, Konstantini i Madh, Justini dhe Justiniani I, në kuadër të reformave perandorake jo rastësisht Ilirikun e ngritën në nivelin e një province kyçe midis pjesë perëndimore dhe lindore, e cila do të jetë arenë e zhvillimeve më të rëndësishme të shekujve në vijim ku do të sprovohet vitaliteti i Perandorisë Romake si fuqi botërore.

Me lejimin që fiset barbare sllave, të vendoseshin në pjesët ku kryesisht jetonin Dardanët (nga Danubi në drejtim të derdhjes së lumenjve Moravë dhe Ibër) si dhe në drejtim të Savës dhe në Dalmaci, ku jetonin Ilirët, Herakli filloi procesin e çrregullimit të etnisë tashmë administrative, shoqërore dhe shpirtërore ilire-dardane ndër më të qëndrueshmet në atë pjesë që ia mbante baraspeshën ngrehinës perandorake, e cila prej më shumë se një shekulli u kishte bërë ballë sulmeve të barbarëve nga veriu, duke u kthyer kështu në një fortifikatë antisllave, të tillë siç e kishte paraparë perandori Justinian. Ky kishte bërë aq shumë në planin administrativ dhe ushtarak që Dardania në veçanti dhe Iliriku në përgjithë-

---

<sup>348</sup> Po aty, faqe 71.

<sup>349</sup> Po aty, faqe 71.

si, të fitonin fuqi mbrojtëse plotësuese me anën e fortifikimeve, të cilat njëherësh ishin pjesë e një identiteti të veçantë perandorak, ku tashmë puqeshin fryma përrëndimore dhe krishterimi.

Dhe si do të shihet, me fillimin e vendosjes së Sllavëve në këto pjesë (proces ky që do të vazhdojë intensivisht gjatë dy shekujve të ardhshëm) si dhe me kyçjen e tyre në armatë (jo më si mercenarë siç kishte ndodhur herë pas here kur ata ishin angazhuar për nevoja të caktuara dhe kishin kryer shërbime të shumta) - me dhënien e të drejtës që të krijonin bashkësitë e tyre familjare-fisnore (zhupanitë), që ishin të një mentaliteti tejet primitiv krahasuar me atë që kishin Dardania dhe Iliriku (mjafton të përmenden këtu vetëm qytetet madhështore që kishte ndërtuar Justiniani në Dardani nga Justiniana Prima, Justiniana Secunda dhe shumë e shumë të tjera, ku kjo e para ishte kthyer në vikariat dhe kryeqendër të kishës së Ilirikut e lidhur drejtpërdrejt me Selinë e Shenjtë) - do të fillojë koha e sllavizimit të dhunshëm të Perandorisë në pjesën përrëndimore të Ilirikut, siç do të fillojë edhe përjashtimi i kulturës së antikitetit që mbështetej në vlerat e universalizmit botëror, pikërisht asaj që kishte kultivuar Perandoria Romake dhe popujt që e kishin ndërtuar atë dhe kjo do të bëhet fillimisht me kthimin e gjuhës greke në gjuhë zyrtare dhe më vonë edhe futjen e saj në liturgji dhe administratë vendore, me çka shfaqet greqizimi i plotë dhe klerikalizimi i fuqishëm i gjithë jetës publike.

Ç'është e vërteta, në pjesën Lindore gjuhës latine si gjuhë administrate dhe e armatës qysh moti kishte filluar t'i hiqej dheu nën këmbë. "Bilinguizmi", si masë e parë e përgatitjes së terrenit që një ditë në Lindje të fitojë greqishtja, do të vijë pikërisht nga kisha e Kostandinopojës me arsyetimin se populli kërkonte meshën në gjuhën që kuptonte, pra greqishten, edhe pse ajo asnjëherë nuk do të kthehej në "gjuhë populli" për faktin se mbeti vetëm në kishë dhe në administratë. Herakli i dha fund kësaj gjendje dhe gjuha greke u bë gjuhë zyrtare e Perandorisë Bizantine.<sup>350</sup>

Që ta forcojë greqizmin edhe më tepër dhe atë ta kthejë në fundament të shtetit të Bizantit, Herakli hoqi dorë nga titujt perandorakë latinë dhe u quajt *basileus*, sipas emërimit popullor grek. *Basileus* u bë titull zyrtar i perandorit bizantin dhe konsiderohej titull i vërtetë perandorak, që do të heqë nga përdorimi *cezarët*, imperatorët Romakë. Me këtë do t'i hapet rruga ndarjes përrfundimtare edhe kishave në atë të ritit latin, me qendër Vatikanin dhe në atë të ritit ortodoks me qendër Kostandinopojën, ndarje kjo që nga shekulli i njëmbëdhjetë e këndej,

---

<sup>350</sup> Zilliacus, H: "Zum Kampf der Weltschprache im oströmischen Reich", Helsingfors, 1935, faqe 36.

duke kaluar mes për mes Ilirikut dhe asaj që më vonë do të shfaqet si hapësirë etnike arbërore e më vonë shqiptare, do të paraqesë edhe kufirin e ndarjes së qytetërimeve dhe të luftërave të ashpra dhe të pandalshme që do të zhvillohen mbi bazat e kësaj ndarje.

## ILIRËTNË KUADËR TË MENDËSISË SË HERSHME BIZANTINE

Hapja e rrugës fiseve barbare sllave për t'u vendosur në Ilirik dhe zyrtarizimi i gjuhës greke në njërin anë do ta qëllojnë drejtpërdrejt identitetin administrativ, atë shoqëror dhe kulturor ilir-dardan, që kishte filluar të legjitimohej nga koha e perandorit Dioklecian, Konstantini i Madh dhe veçmas Justiniani, dhe në tjetrën anë do të shkojë në të mirë të helenizimit të Perandorisë Bizantine duke e kthyer atë përfundimisht kah Lindja. Me këtë e gjitha do të shkojë në dëm të frymës së universalizimit botëror, që kishte karakterizuar Perandorinë Romake në shekujt paraprakë kur ajo kishte arritur kulmin e fuqisë dhe të lavdisë. Perandori Heraklit, që erdhi në pushtet me ndihmën e ushtrisë së ekzarkatit të Kartagjenës dhe të kishës së Kostandinopojës, ndihmën e kësaj të fundit do ta pranojë më shumë se një aleancë që i duhej kurorës së fronit për të fituar besimin e popullatës së atjeshme. Ndërsa Kostandinopoja këtë do ta shfrytëzojë për dividendë shoqërore dhe politike ndër më të mëdhatë për ta kthyer në një kapital të përhershëm me të cilin ajo do të bëhet bashkëpjesëtare e kurorës perandorake dhe e pushtetit për shekuj me radhë derisa do të marrë fund Bizanti, kur Kostandinopoja do të bjerë në duart e Osmanëve. Madje, edhe atëherë, pra kur do të bjerë nën Osmanët, kisha ortodokse me të shpejtë do t'u përshtatet rrethanave duke ruajtur diçka nga pozita që kishte gjatë Bizantit, gjë që mund të thuhet se edhe pse nuk ishte në pushtet si më parë, megjithatë ishte në shërbim të pushtetit të ri.

Duke u lidhur me Kostandinopojën dhe kryqin e saj, Herakli njëherësh shkëputej përfundimisht nga kisha romake dhe nga Perëndimi në përgjithësi, shkëputje kjo që për pasojë pati jo vetëm ndarjen por edhe armiqësimin me të, veprim ky që së pari dhe më së rëndi do të prekë Ilirikun, sepse nga pikëpamja administrative, si provincë i takonte Lindjes. Ndërsa nga pikëpamja kishtare i takonte Perëndimit, pra kishës së Romës, ku do të mbetet deri në shekullin IX, kur si dihet, pas vendimit arbitrar të Leonit III do t'i takojë juridiksionit të Kostandinopojës. Ky vendim do të përlligjet në koncilin VIII të Kostandinopojës të vitit 869-870, me ç'rast pjesët e Ilirikut të pushtuara nga Bullgarët do t'i kalojnë kishës së

Kostandinopojës. Ky fakt do të ketë për pasojë mosparjen e qëllimshme të iliro-daradanëve për katër shekuj me radhë, në mënyrë që gjurmët t'u shihen “befasisht” në shekullin XI, si *Arbër, Albanë, Rabanë* dhe ndryshe.

Para se të ndodhte ky zhvillim, duhet thënë se Iliriku do të përfshihet me të madhe dhe do të luajë rol aktiv në atë që do të shfaqet si mendësi mesjetare, e cila do të dalë në skenën historike nga pranimi i krishterimit si fe zyrtare e këndeje, që do të bëhet nga perandori dardan, Konstantini i Madh në vitin 319, për të vazhduar në të gjitha fazat deri sa do të kthehet në një dogmë shoqërore dhe politike çfarë në të vërtetë njihet.

Meqë, si dihet, shfaqja e misionarëve të krishterë, e me këtë gjurmët e krishterimit në Ilirik dhe Dardani datojnë nga shekulli i parë i erës sonë,<sup>351</sup> atëherë është e pritshme që në këtë hapësirë të kemi ndeshjet e para midis monoteizmit dhe politeizmit, midis krishterimit dhe paganizmit në një formë bukur të ashpër ngase perandoria pagane romake sprovën e saj kryesore të depërtimeve në Lindje e kishte dhënë në këtë nyje, e cila përçohet me rrugët tokësore dhe ujore, që lidhin Perëndimin me Lindjen ngaherë. Sfida e re, e shfaqur në Lindje dhe po përhapej në të gjitha anët, nënkuptonte edhe ballafaqimin e pashmangshëm me të në këtë hapësirë kryqëzimesh ndër më të rëndësishmet prej nga depërtimi në Perëndim varej nga mbështetja që mund ta fitonte në këto anë dhe anasjelltas. Madje, Perandoria Romake, e vetëdijshme për këtë gjë, jo rastësisht do të ndër-marrë masat më të ashpra kundër misionarëve në këto anë, prej nga kemi edhe martirët e parë nga Dardania të njohur si: Flori, Lauri, Prokuli dhe Maksimi. Këta dhe të ngjashmit thuhej se shpërndaheshin në Perëndim dhe në veri-lindje për t'u futur edhe në Itali.<sup>352</sup> *Acta Sanetorum* përmend edhe vendlindjen e tyre, Dardani-në si dhe emrin e qytetit ku u torturuan, Ulpianën. Aty bëhet e ditur se ata ishin gdhendës të gurit dhe mund të ishin edhe binjakë. Edhe pse nuk dihet data e saktë e martirizimit të tyre, ajo megjithatë lidhet me kohën e perandorit Hadrian (117-138), i cili ishte i njohur për ashpërsinë ndaj çfarëdo mësimi të krishterë që shfaqej në këto anë.<sup>353</sup>

Megjithatë, vendosja apriori e mendësisë mesjetare në Iliri dhe Dardani në kuadër të krishterimit si një doktrinë që ka të bëjë me fitoren e monoteizmit ndaj politeizmit, thyen klishtë me të cilat është bërë përpjekje që misionarizmi i kri-

---

<sup>351</sup> Më gjerësisht shih: Gjini, Gaspër: “*Skopsko-prizrenska biskupija kroz stoljeća*”, Zagreb, 1986.

<sup>352</sup> Forlatus D: “*Iliricum Sacrum*”, vëllimi, VIII/2, Venetiis, 1751-1819,

<sup>353</sup> *Acta Sanetorum*, die 18 augusti, III, Anverpiae 1737, 520-522, cituar sipas Gjini, Gaspër: “*Skopsko-prizrenska biskupija kroz stoljeća*”, faqe 56.

shterë të jetë pranuar duarhapur, siç mund të fitohet përshtypja nga disa burime kishtare bizantine ose edhe nga kronika të kohës, meqë as vetëdija e politeizmit nuk ia kishte dalë që ta mundë njëherë e përgjithmonë atë pagane edhe atëherë kur krishterimi është pranuar religjion zyrtar i Perandorisë. As dogma e krishterë nuk ka qenë në gjendje që të ndërpresë lidhjen me besimin pagan si dhe vetëdijen heretike e as heretizmin (skizmen ariane, e të tjera bindje), të cilat një kohë të gjatë vazhdojnë të ndeshen e madje të konfrontohen në këtë pjesë, ku disa prej tyre, siç ishte arianizmi, patën edhe hapësirën kryesore.

Sa i përket të parës, pra besimit pagan dhe kulteve, mjafton të përmendet e dhëna se edhe vetë perandori Konstantini i Madh – zyrtarizues i krishterimin për arsye politike, personalisht nuk kishte hequr dorë nga vetëdija pagane e as që e ndaloi atë kur pranoi krishterimin. Thuhet se në shtratin e vdekjes do të kërkojë kungim (ani pse kjo nuk është parë diku jashtë burimeve kishtare, gjë që mund të merret edhe si spekulim i saj për nevoja të kishës), edhe pse dihet se ishte varrosur sipas ritit pagan në një sarkofag të stolisur me hardhinë e rrushit, kult i rëndësishëm dardan që nga koha e Pellazgëve. Me këtë më së miri shpjegohen dilemat, përpëlitjet dhe gjithë ato që do ta përcjellin këtë pjesë para dhe gjatë asaj që do të merret si mendësi mesjetare, e cila, siç shihet nga varrimi i Konstantinit të Madh, asnjëherë nuk ka pasur mundësi të jetë në nivelin e dogmës së plotë, meqë “e reja” nuk ka qenë në gjendje asnjëherë ta përjashtojë “të vjetrën”, siç nuk ka qenë në gjendje që “e vjetra” ta pengojë depërtimin “e së resë”.

Se kjo ishte një luftë e gjatë dhe e ashpër midis botëkuptimeve të ndryshme skajshmërisht të papranueshme, me kthesa herë-herë edhe të paparashikueshme, këtë më së miri e pasqyron edhe dekreti i perandorit Julian, i vitit 361, i cili shpalli përtëritjen e politeizmit, duke hapur tempujt e rrënuar dhe duke përjashtuar priftërinjtë nga detyrimet e ndryshme, madje duke i ndihmuar “të rikthyerit” me shpërblime. Perandori Julian, kishte bindjen se krishterimi ashtu siç shpjegohej nga kleri dhe siç ishte pranuar nga pjesa e zyrtarëve të lartë, nuk ishte tjetër pos një luftë për pushtet që vinte nga poshtë-lartë, pra e shtresës së liruar nga skllavopronaria, e cila kërkonte tretman të ri shoqëror dhe politik në dëm të aristokracisë, ku kisha luante rolin e inspiratorit kryesor duke shfrytëzuar besimin për këto qëllime, të cilat njëherësh puqeshin edhe me prirjet despotike të perandorëve, të cilët kishin nevojë për diçka të tillë. Por, Juliani do të dështojë pas dy vjetësh pikërisht pse liria e besimit nuk ishte në gjendje që ta mbronte besimin e lirë nga dogma e krishterë, që tashmë kishte kaluar në ushqim të masave, të cilave premtimi i barazisë dhe jeta e përshtirshme, qoftë si iluzion, u dukej shumë më e pra-



nueshme nga e drejta e besimit të lirë nga i cili ata nuk shihnin ndonjë përfitim. Dhe nuk do të vonojë e pas vdekjes së Julianit, më 363, perandori Teodosi shpalli me dekret krishterimin si të vetmen fe zyrtare. Për më tepër, pas një viti u vendos që jo vetëm t'i mohohet kultit pagan çdo ndihmë, por edhe të konfiskoheshin pasuritë e tempujve dhe të ndiqeshin adhuruesit e tempujve.

Me një urdhër të vitit 392 u ndalua çdo ithtari nëpër vende private, duke e parë si shkelje ligjore dhe duke kërcënuar me gjobitje e masa ndëshkimore të rrepta.<sup>354</sup>

I kësaj natyre, është i njohur kodi i Teodosit “*De paganissacrificiis et templis*” (Mbi fljijimet dhe tempujt paganë) në të cilin thuhet:

“*Dekretojmë që kudo të mbyllet tempujt... Askush të mos bëjë fljijime. Nëse ndokush bën shkelje të tilla, le të vritet me shpatën hakmarrëse. Dekretojmë që të konfiskohet pasuria e të vlarëve dhe të dënohen qeveritarët e provincave nëse nuk veprojnë si duhet për zhdukjen e këtyre krimeve*”.<sup>355</sup>

Në këtë zhvillim shoqëror, pra të pranisë së skajshmërive, duhet parë dhe kuptuar Ilirikun dhe në te Dardaninë dhe Maqedoninë si provincat më të rëndësishme të saj, ku ato do të gjejnë vend dhe ushqim thuajse të përhershëm. Andaj, nuk është për t'u habitur pse shtrirja e tyre në shoqëri, politikë dhe sferën shpirtërore, do të bëjnë që kufijtë administrativë e pastaj ata kishtarë, që shfaqen nga shekulli XI e këndeje, ta kthejnë në një hapësirë të ndeshjes së ashpër midis ritit lindor dhe atij perëndimor të krishterë, ndërkohë që pas katër shekujsh, kur do të shfaqet islami, ta kthejnë edhe në një hapësirë të ndeshjeve të qytetërimeve.

Në të vërtetë, mendësinë ilire-dardane gjatë mesjetës, pra në rrethanat kur dogma e krishterë do të bëjë përpjekje të pareshtura që të absolutizojë çdo të vërtetë nga ato shpirtërore, shoqërore dhe politike, më shumë duhet parë te përcaktimet që të ruhet hapësira e të menduarit “ndryshe” ose herezinë, edhe brenda saj që do të shihet doktrinë kishtarë në përputhje me mësimet e shenjta.

Në Dardani, krahas shfaqjes së parë të Testamentit të Vjetër të përkthyer në gjuhën latine, apo si quhej “*vulgatë*”, nga iliri Shën Jeronimi ose Jeronim Eusebi i quajtur edhe Shën Gjeri, në këto anë sikur gjejnë truall tejet të përshtatshëm edhe dallimet midis *monofizitëve* dhe *dyfizitëve*, të ardhura nga pjesët e largëta të Perandorisë (Armenia dhe Egjipti), pra të dy rrymave të njohura brenda kishës. Njëra anë mbronte qëndrimin rreth natyrës së frymës *njeri-perëndi* dhe të tjetra atë e shihte të përfaqësuar nga i biri i zotit, Jezui si frymë e tij. Edhe pse kjo grin-

<sup>354</sup> Sokoli, Ramadan: “16 shekuj”, Tiranë, 1996, faqe 20.

<sup>355</sup> Po aty, faqe 20.

dje në njëfarë dore do të mbyllet në koncilin e Nikesë kur do të arrihet pëlqimi rreth *natyrës së trinitetit* pra të atit, të birit dhe të shpirtit të shenjtë, doktrinë kjo që përfundimisht do të legjitimohet në koncilin e tretë, atë të Kalcedonit në vitin 451, megjithatë, do të jetë të menduarit heretik, që edhe më këndeje do të qarkullojë mjaft lirshëm në Dardani dhe Ilirik, si një fraksion i fuqishëm brenda kishës me qendër në Aleksandri, por që do të mbështetet edhe nga kisha e Armenisë dhe një pjesë e mirë e peshkopëve të Dardanisë. Me këtë arianizmi kthehet në një kërcënim të madh për dogmën kishtare, meqë me këtë mësim nuk pranohej natyra hyjnore e Jezuit e as kallëzimi se ishte bir “jo legjitim” i zotit që e kishte lindur Maria. Arianët, të cilët ishin me ndikim të madh qysh në fillim dhe madje ishin edhe shumicë, përjashtonin këtë mësim dhe, mund të thuhet se ishin shumë të fuqishëm dhe me ndikim, veçmas në pjesën e Dardanisë dhe të Ilirikut, ku ruhej “mendimi ndryshe”. Se çfarë ndikimi kishte arianizmi në këto pjesë kjo më së miri shpjegohet me pranimin e krishterimit nga Gotët e variantit arian, i cili, nga Dardania, u përhap me të shpejtë në pjesët veriore të Perandorisë, prej nga do t’i mbetet ndikimi edhe pas përfundimit të mbretërisë së tyre në Itali dhe Dalmaci.

Se e ashtuquajtura skizmë midis peshkopëve dardanë, nuk ishte vetëm një “ndikim rasti nga qëndrimi i Arijanit në Dardani”<sup>356</sup>, që e kishte si dënim, pas Konkilit të Dytë që u mbajt në afërsi të Kostandinopojës me kërkesën e Kostantinut të Madh, i cili kërkonte rregull në kishë në vend të grindjeve rreth frymës së zotit midis njerëzve. Këtë e tregon më së miri rasti i peshkopit të Naissusit, Bonozi, i cili haptas kundërshtoi virgjërinë e Marisë, siç kishin vepruar edhe heretikët Helvedi dhe Joviniani. Sipas Bonozit, Maria, pas Jezuit, kishte edhe fëmijë të tjerë me Jozefin.

Kjo herezi do ta shqetësojë kishën, e cila në koncilin e Kaldeconisë do të kërkojë që peshkopët e Dardanisë dhe ata të Ilirikut të distancoheshin nga peshkopët heretikë të udhëhequr nga Bonozi.

Natyrisht se një hetim i koncilin, me shumicë votash, do ta shpallë Bonozin heretik me çka ai do të përjashtohet nga veprimtaria kishtare. Por, bëhet e ditur se peshkopi kryeneç jo vetëm që nuk do të pranojë dënimin dhe as që do të pendohet, por do të vazhdojë me të tijën edhe për një kohë të gjatë në Dardani dhe pjesët e tjera përreth nga ai sillej,<sup>357</sup> çka len për të kuptuar se arianizmi edhe më këndeje kishte përkrahës në këto anë.

---

<sup>356</sup> Gjini, Gaspër: “*Skopsko-prizrenska biskupija kroz stoljeća*”, Zagreb, 1986, faqe 33.

<sup>357</sup> Po aty, faqe 33.

Edhe përkundër këtyre përvijimeve, të cilat do të jenë të ashpra, pa marrë parasysh “pajtimet” që bëheshin nga koncili në koncil dhe pa marrë parasysh ruajtjen formale të shtrirjes juridiksionale midis kishës së Romës dhe asaj të Kostandinopojës, luftërat e brendshme të njëjës apo tjetrës kishë për ndikim sa më të madh do të vazhdojnë me metoda të ndryshme dhe shumë herë meskine, ku rëndom forcimi apo dobësimi politik i njëjës apo anës tjetër do të shfrytëzohet për favore kishtarë.

Megjithatë, gjendja që kishte vendosur Justiniani me novelën e parë dhe të dytë të vitit 535 dhe 545 kur Justiniana Prima do të shpallet kryeqendër e peshkopatës së Ilirikut dhe vikariati i saj do të lidhet drejtpërdrejt me Selinë e Shenjtë, pra kur kisha dardane do të ngrihet në nivelin më të lartë shtetëror, edhe përkundër çrregullimeve dhe rrënimëve të njohura politike dhe shoqërore që do të ndodhin pas ardhjes në pushtet të Heraklit, kur do të fillojë greqizimi i jetës në pjesën lindore dhe me këtë edhe procesi i shkëputjes që do të çojë te ndarja me Romën, Dardania, së paku formalisht, do të vazhdojë të ruajë diçka nga gjendja e vjetër, edhe pse kjo do t’ia ngushtojë mundësitë e veprimit, që kishte dikur. Dhe, kjo diçka gjithsesi se kishte të bënte me ruajtjen e lidhjeve me Selinë e Shenjtë, së cilës edhe më tutje i respektohej juridiksioni derisa në mënyrë arbitrare nga Perandori Leoni III më 733 do t’i hiqet për t’u legjitimuar në koncilin VIII të Kostandinopojës më 870.

Kur jemi te perandori Leoni III dhe ato që do të pasojnë më pas në Koncilin VIII kur Iliriku dhe Dardania humbën njëherë e përgjithmonë vendin që kishin nga koha e Dioklecianit, Konstantinit të Madh dhe Justinianit, pra në përpjekje që të përbyset çdo gjë e identitetit administrativ, shoqëror dhe kishtar te tyre, që ishte e lidhur me kishën perëndimore si dhe qytetërimin që vinte prej andej, duhet përmendur edhe luftën kundër ikonave që ishte kthyer në një konflikt të brendshëm kishtar ndër më të mëdhenjtë dhe ndër më të diskutueshmit. Dardania dhe përgjithësisht Iliriku ishte mbërthyer më së shumti në të, meqë administrativisht përfshiheshin në pjesën lindore të Perandorisë, ndërsa nga aspekti kishtar përfshiheshin në kuadër të Kishës Perëndimore, pra Selisë së Shenjtë. Në thelb të atij konflikti të gjatë, të ashpër dhe me pasoja të mëdha shoqërore dhe politike për gjithë Perandorinë, qëndronte interpretimi i ndryshëm që i bëhej rolit që imazhet e shenjtja (ikonat) kishin në besimin e krishterë.

*Lufta për dhe kundër ikonave* që u hap me të madhe dhe u kthye në një konflikt kishtar tejet të ashpër, pos të tjerash nxori në shesh, dallimet e mëdha kulturore, shoqërore por edhe politike, midis Perëndimit që kërkonte që dogma

kishtare të mos e ngulfaste artin dhe në përgjithësi krijimtarinë, por që edhe te motivet kishtare të shfrytëzohej liria e krijuesit për të qenë sa më kreativ, gjë që ishte në përputhje me kulturën pagane e cila edhe më këndeje ruhej te një pjesë e madhe e Ilirikut, por edhe tek të tjerët në perëndim, ndërkohë që kisha lindore, pra Kostandinopoja, kërkon dogmë të ashpër në art dhe krijimtari, ku krijuesit duhej t'u përmbaheshin dymbëdhjetë urdhrave apostolike rreth imazhit (ikonave) dhe asgjë tjetër nuk duhej të paraqitej. Kjo ishte në përputhje edhe me ndikimin që ushtronin mbi krishterimin bizantin feja islame dhe ajo hebraike, të cilat ndalonin fare pikturimin e shenjtëve si dhe motivet që kishin të bënin me ta.

Gjatë kohës së Justinianit, i cili bëri që kisha e Dardanisë, pra qendra e saj Jusitiana Prima, të kthehet në vikariat dhe në kryepeshkopatë të Ilirikut e lidhur drejtpërdrejt me Selinë e Shenjtë, në kishat e kësaj ane do të lulëzojë arti i ikonave dhe ato gjithkund do të stolisen me këto motive. Imazhet kishtare (ikonat), jo vetëm që do të jenë të lira, por ato do të kthehen në njëfarë lirie krijuese, thuajse të ngjashme me atë që do të shfaqet në kohën e renesancës, kur arti dhe krijimtaria, pas shekuj robërie, do të lirohen nga dogma e krishterë dhe do t'i nënshtrohen vrullit të lirë.

Edhe gjatë kohës së Justinianit, *ikonolatria* (adhurimi i ikonave), që kishte mbështetje të madhe në Iliri, por edhe në pjesët e tjera perëndimore që ishin nën juridiksionin kishtar të Selisë së Shenjtë, do të ketë përpjekje që *ikonoklastët* (urrësit e ikonave) të kthehen në shumicë dhe me këtë t'i japin fund asaj që mund të merrej si hapësirë e lirë krijimi brenda artit të krishterë. Në Lindje madje, ikonoklastia jo vetëm që u forcua, por ajo u kthye në një *sekt pavlikan*, që luftonte kundër çdo forme kulti fetar dhe këtë e bënte dhe me ndërhyrje të ashpra duke rrënuar veprat dhe ndëshkuar edhe krijuesit.<sup>358</sup>

Kështu, lufta midis përkrahësve të ikonave dhe urrejtësve të tyre, do të vazhdojë edhe pas vdekjes së Justinianit për t'u kthyer në një grindje të ashpër midis kishës së Kostandinopojës, e cila pas ardhjes në pushtet të perandorit Heraklit, do të fitojë legjitimitet të plotë në Lindje, dhe Selisë së Shenjtë do të vazhdojë edhe për më shumë se njëqind vjet, deri kur do të shfaqet Leoni III me dekretin e tij të njohur në mbrojtje të ikonoklastisë. Me pretekstet që ikonolatristet dhe përkrahësit e tyre të shumtë në kishën e Dardanisë kishin filluar t'ua merrnin anën mësimëve të shenjta dhe pikëpamjeve të drejta kishtare, Leoni III, pra me arsyetime se duhej t'i jepej fund herezisë që ishte shfaqur në pjesën perëndimore, në vitin

---

<sup>358</sup> Gjini, Gaspër: "Skopsko-prizrenska biskupija kroz stoljeća", Zagreb, 1986.

732, në mënyrë arbitrare, shkëputi kishën e Dardanisë nga juridiksioni i Selisë së Shenjtë dhe e vuri nën varësinë e drejtpërdrejtë të Patriarkatit të Kostandinopojës. Sipas kësaj mase, kleri i krishterë në këto anë, fitonte mundësi “më të mira” që të mbikëqyrej, që të mos e humbte rrugën e vet.

Ky veprim, megjithatë, nuk ndërpreu as adhurimin e ikonave, e as që e ktheu kishën dardane në një pasuese të vullnetshme të kishës së Kostandinopojës, siç mendohej se do të ndodhte pas këtyre masave të njëanshme. Përkundrazi, Iliriku, me përjashtim të peshkopatës së Durrësit, vazhdoi të ruajë edhe lidhjet me Selinë e Shenjtë, gjë që u tolerua nga i biri i Leonit III, Konstatini V, i cili pasi që do të vijë në pushtet pas vdekjes së të et, më 746, do të ketë punë me sulmet arabe, me të cilët do të ndeshet po atë vit në Siri dhe do t’u sjellë humbje Omajadëve, e cila pas një lufte të gjatë u zëvendësua nga dinastia e Abasidëve (750) e cila zhvendosi qendrën e shtetit nga Damasku në Bagdad. E ëma e perandorit, Irena, që ishte nga Athina, ku vazhdonte adhurimi i ikonave, kërkoi që të gjendej një gjuhë pajtimi me adhuruesit e ikonave, por i biri nuk pranoi. Ai u bë edhe më i ashpër dhe kërkoi që qëndrimin ikonoklast ta përligjë edhe me një koncil kishtar, atë të shkurtit të vitit 754 që u mbajt në pallatin perandorak të Hierës në begun aziatik të Bosforit. Në gusht të atij viti, në forumin e Kostandinopojës u shpallën vendimet e sinodit, i cili ndalonte në mënyrën më të ashpër figurat e kultit, urdhëronte shkatërrimin e të gjitha statujave të kultit dhe dënonte me çkishërim përkrahësit e parisë ortodokse, ndër të cilët edhe patrikun German si dhe Johan Domaskenin, të cilët nuk pranuan që ikonat ku adhurohej Jezui të zëvendësoheshin me pikturat me tematikë profane, ku zbukurimet ornamentale me motive kafshësh e bimësh, midis të cilave portretet e perandorit në gjah, duhej të mbushnin muret e kishave dhe të dyerve të tyre.<sup>359</sup>

Edhe pse arti profan nuk do të përfillet thujse fare në Dardani dhe Ilirik si dhe në pjesën më të madhe të juridiksionit të Selisë së Shenjtë, ndërkohë që midis së ëmës, Irenës, dhe të birit Konstantinit V do të ashpërsohen marrëdhëniet deri aty sa pas një komploti të vijë në pushtet i biri tjetër më i ri, Konstantini VI, i cili po ashtu do të vritet nga e ëma më 15 gusht 797. Megjithatë, kthimi i adhurimit të ikonave, nuk e ktheu kishën e Dardanisë dhe të Ilirikut nën mbikëqyrjen e plotë të kishës së Kostandinopojës, edhe atëherë kur ishte më se e qartë se pas marrëveshjes së papa Stefanit II me mbretin e Longobardëve, Pipin në janar të vitit 754, kishte hedhur bazat e shtetit të kishës romane të lidhur me mbretërinë e

---

<sup>359</sup> Po aty.

Frankëve, në mënyrë që përgjithmonë t'ia kthejë krahët perandorit bizantin, ani pse siç dihet, pikërisht nga një lidhje e tillë, pas një gjysmë shekulli mori jetë Perandoria e Perëndimit.

Me gjithë këtë shpërputhje të madhe, shekujt III-IX, të cilët nga aspekti shoqëror dhe politik duhet vlerësuar si kohë të shfaqjes por edhe të paraqitjes së shtetësisë ilire-dardane brenda Bizantit - ngaqë si nga aspekti administrativ, ai shoqëror, politik dhe shpirtëror (besimi) kjo perandori do të ngrihet dhe ndërtohet edhe në saje të iliro-dardanëve, të cilët, krahas të tjerëve (Helenëve, Armenëve, Dakëve) do të kthehen në mbështetës të saj kryesorë - ata duhet parë edhe si pjesë të një zhvillimi kulturor që do ta plotësojnë këtë identitet edhe brenda dogmës kishtarë dhe gjithë asaj që lejonte dhe mundësonte mendësia mesjetare, ku krijuesit e shumtë ilirë dhe dardanë do të arrijnë majat e artit bizantin, që nga muzika, arkitektura, dhe të menduarit teologjik. Shfaqja e Niketë Dardanit dhe veprave të tij muzikore që do t'ia japin vulën gjithë arti mesjetar, pastaj roli i madh i Shën Jeronimit, që me përkthimin e Testamentit të Vjetër të përhapë mendimet e saj në Perëndim dhe kështu t'i ndihmojë pranimit sa më të madh të krishterimit, pastaj shfaqja e arkitektëve të shumtë dhe të artistëve në të gjitha fushat, bëjnë të ditur për një zhvillim material dhe kulturor të Iliro-Dardanëve.

Gërmimet arkeologjike kanë nxjerrë në dritë rrugë të shtruara me gurë të mëdhenj, mbetje tempujsh e faltoresh, banjash, banesash, ujësjellësish, mbishkrimesh e një mori gjetjesh të tjera nga poçeria, qeramika e ndërtimit, modelet arkitekturore, mozaikët dhe monedhat, që bindin për kushtet e përshtatshme të lulëzimit kulturor e artistik të vendit në përputhje me rrethanat. Arkeologët na sigurojnë se të gjitha gjetjet e shekujve V dhe VI në Preval dhe në Dardani të Shqipërisë Veriore dhe në Epirin e Vjetër e të Ri në Jug dëshmojnë për një kulturë materiale uniforme. Kështu, në afërsi të Naissusit (Nishit të sotëm) janë zbuluar gjurmët e një pallati madhështor të ndërtuar gjatë shekujve III-IV nga perandori Galeri, dhëndri i Dioklecianit. Mbetje të pallateve madhështore janë gjetur edhe afër Prishtinës (ato të Ulpianës dhe të Jusitiana Secunda), pastaj të Therandës afër Prizrenit, të Justiniana Prima bashkë me ato të Scupit të vjetër afër Shkupit, disa themele të pallateve në Vendinis afër Podujevës dhe në shumë e shumë pjesë të tjera të Kosovës dhe të Maqedonisë.<sup>360</sup>

---

<sup>360</sup>Shih: Shukriu, Edi "Ancient Kosova", Prishtinë 2004, "Dardania paraurbane", Pejë 1966; "Fortifikata e Veletinit", Arheološko društvo Jugoslavie, Lubjana; „Gradina e Gushicës dhe municipium Labuza”, Vjetar XXVII –XVIII, Prishtinë; Kovaljević, G: "Kasnoantička palata u Nerodimlju" te „Starine Kosova IX“, Prishtinë 1989.

Pikërisht në atë kohë, pra në fillim të shekullit IV, zuri fill edhe tradita e bazilikave të mirëfillta, të cilat ishin të ndërlidhura me krijuesit pararendës, të cilët shfrytëzuan traditën e artit pagan me shtylla të larta. Por, jo vetëm kaq. Mbi gërmadhat e artit pararendës u shfaq arti i ri paleokristian, duke përthithur elementet e lashtësisë, për të shprehur nëpërmjet tyre përmbajtjen e botëkuptimit të ri civilizues.

Ky art dhe kjo fuqi, megjithatë, nuk ia doli, të mbijetojë as në planin shoqëror as në atë politik e as në atë kulturor ashtu si duhej, meqë krahas kundërshtarëve të brendshëm që kishte (rrymat e ndryshme brenda kishës, të cilat shprehjen e madhështisë krijuese dhe të lirisë, pra kur bëhej dominuese, gjithnjë e lidhnin me herezinë, që si e tillë frenohej ose luftohej), kishte edhe kundërshtarët e jashtëm - fiset barbare nga Veriu, të cilat sa herë depërtonin në pjesën perandorake (dhe ajo kryesisht ishte ilire-dardane), e rrënonin pamëshirshëm. Kështu ndodhi edhe gjatë depërtimeve të Avarëve, të Hunëve, por mbi të gjitha me rastin e atyre sllave, që për ndryshim prej të parëve, që hynin e dilnin duke lënë pas shkretim, këta të fundit, nga shekulli VII e këndej, jo vetëm që nuk do të largohen, por do të mbesin në pjesët që do t'i pushtojnë, duke i kthyer në zotime të përhershme, me ç'rast ato krahas rrënimit që përjetonin, gjykoheshin të mbeteshin jo vetëm të shkëputura nga qytetërimi që kishin, por nën trysninë e një gjendjeje shoqërore dhe politike thuajse barbare, të ngjashme me atë fisnore që kishin nga stepat aziatike prej nga vinin.

# KAPITULLI I DYTË

## SLLAVËT NË ILIRIK

### DYNDJET E SLLAVËVE DHE KRIZA E PARË E BIZANTIT

Është thënë se krishterimi dhe dyndjet (pushtimet) sllave ia ndryshuan kahun mesjetës si dhe rrjedhës së historisë europiane në përgjithësi. E para është e justifikueshme në planin shpirtëror, shoqëror dhe politik, jo vetëm në shfaqjen e Bizantit si vazhdim i Perandorisë Perëndimore, nga fryma e të cilit pak nga pak do të largohet për t'u kthye në një Perandori Lindore, por edhe si faktor që do të marrë përmasa që kanë të bëjë me rrjedhat e përgjithshme të qytetërimit tonë. Sa për Sllavët dhe dyndjet (pushtimet) e tyre, mund të thuhet po ashtu se prodhuan ndryshime të mëdha me pasoja shoqërore dhe politike, për faktin se u kthyen në aktorë që u shfrytëzuan për ndryshime të rëndësishme shoqërore dhe politike nga Bizanti e deri në ditët tona, veçmas në raportet midis Perëndimit dhe Lindjes për mbizotërim të ndërsjellë, çështje këto që varësisht nga kundrimet dhe interesat e caktuara, vlerësohen në mënyra të ndryshme të shumtën nga prodhimi i pasojave.

Edhe përkundër kësaj, mund të thuhet se dyndjet (pushtimet) sllave dhe vendosja e tyre në Ilirik, pa marrë parasysh kohën e njëmendët të shfaqjes së tyre, e përcjellë me shumë e shumë paqartësi dhe spekulime madje që vazhdojnë dhe, pa marrë parasysh faktorët e jashtëm dhe të brendshëm që e kushtëzuan këtë, shfaqja e tyre preku thellësisht gjendjen e tre popujve kryesorë të Ilirikut të atëhershëm: Ilirëve, Grekëve dhe Latinëve,<sup>361</sup> për t'u kthyer në katalizatorë të realiteteve të reja, por që kjo prekje, për nga pasojat, u pasqyrua në mënyra të ndryshme te secili popull veç e veç.

Dhe, këto ndryshime, duke u parë në përputhje me pasojat por jo edhe me faktorët që i kushtëzuan dhe jashtë një vazhdimësie historike nga kohët më të lashta e këndeje, jo rrallë krijuan një pasqyrë të paqartë ose të gabuar të zhvillimeve, veçmas kur faktorët e njëjtë vlerësohen ndryshe-ndryshe, siç ka ndodhur

---

<sup>361</sup> Më gjerësisht shih: Porphyrogenitus, Constantinte: “*De administrando Imperio*” Washington, 1967; Hirsch, F: “*Gyzantinische Studie*”, Leipzig, 1878; “*The Oxford Dictionary of Byzantium*” I-III, New York-London, 1991; Schreiner: “*Die Byzantinischen Kleinkroniken*” I, II, III, Wien, 1975-1979; Schewill, Janin, R: “*La geographie ecelestionstique del l’ Empire Byzantine*”, I-III, Paris-Bucarest 1899-1916; Ferdinand: “*Iliriku – historia dhe qytetërimi*”, Tiranë 2002, faqe 72-75; Ostrogorski, Georg: “*Historia e Perandorisë Bizantine*”, Tiranë 2002, faqe 108-149; Jireček, Konstantin: “*Historia e serbëve*”, pjesa e parë, Tiranë 2010, faqe 87-108; Malcom, Noel: “*Kosova një histori e shkurtër*”, Prishtinë 2001, faqe 23-42; “*Historia e Popullit Shqiptar*”, Tiranë 2002, faqe 203-209; Shufflay, Milan: “*Histori e Shqiptarëve të veriut*”, Prishtinë 2009, faqe 21-35.



në të vërtetë me Ilirët dhe pasardhësit e tyre (nga Mesjeta e vonshme Arbrit dhe më vonë Shqiptarët), të cilët në raport me Grekët dhe Latinët, shkëputen njëanshëm nga përbashkësia perandorake bizantine, për t'u parë në margjina, apo fare vonë, me çka, pas pesë-gjashtë shekujsh, shfaqja e tyre e pashmangshme të duket sa e "rastësishme" dhe po aq "jo e natyrshme", prej nga pastaj do të ushqehen "hutitë" dhe qasja joshkencore që do t'i bëhet kësaj çështje.

Vlerësimi se dyndjet (pushtimet) sllave në Ilirik prekën thellësisht gjendjen e Ilirëve, Grekëve dhe Latinëve, më së shumti ka të bëjë me Ilirët, meqë u ballafaquan me pasoja negative dhe tepër të rënda fillimisht dhe në vazhdimësi. Kur thuhet kështu kihet parasysh e dhëna se ata dhe hapësira e tyre ishin shënjestra e parë që iu nënshtrua veprimeve të ndryshme ndër më të ashprat, që prekën etninë si dhe raportet e tyre shoqërore në mënyrë të drejtpërdrejtë fizikisht dhe politikisht. Sa u përket pasojave që pat dyndja sllave për Latinët dhe Grekët, mund të thuhet se ajo përshpejtoi procesin e ndarjes së Latinëve nga Grekët ashtu që të parët (latinët) do t'i bashkohen Perandorisë së Shenjtë Perëndimore që do të lindë pas kohës së Karlit të Madh e këndej, ndërsa Grekët, praninë e Sllavëve do ta kthejnë në një favor thuajse të përhershëm politik, shoqëror dhe veçmas kulturor. Gjuha greke me zyrtarizimin e saj do të kthehet edhe në gjuhë liturgjie me çka, si do të shihet, në proceset e mëtejshme përfshirja, por edhe akomodimi i Sllavëve në Perandorinë Lindore, do të bëhet nën ndikimin e drejtpërdrejtë të supremacionit helen dhe të fuqizimit të tyre. Kjo do të pasqyrohet më së miri pas pranimit të krishterimit nga ana e Sllavëve, ndonëse fillimisht lidhjet më të mira do t'i kenë me kishën perëndimore (fjala është për fiset e përqendruar në Bosnje dhe Zaxhlumi, ku do të kenë bërthamën e njëmendët shoqërore dhe politike para se të bartet në Rashë nga Nemanja dhe dinastia e tij).

Ndarja e brendshme sllave, që kryesisht përkufizohet me pranimin e krishterimit dhe, ka të bëjë me mesin e shekullit IX dhe fillimin e shekullit X, ka rëndësi të veçantë, meqë kjo, në të vërtetë, paraqet strukturimet e para shoqërore dhe politike të tyre në nivel të organizimit familjar e fisnor brenda Bizantit dhe jo siç thuhet në shekullin VI, e ndonjëherë edhe më herët, kur depërtimet e tyre herë pas here nga Veriu përtej Danubit, apo bashkëngjitja Hunëve dhe Gotëve, siç ishte rasti me sulmet e tyre ndaj Kostandinopojës nga koha e Hunëve, Avarëve dhe Persëve gjatë kohës së Heraklit, ose ato të Gotëve gjatë kohës së Teodorikut, të lidhen me fillet e "shtetit serb mesjetar". Ai, si dihet, do të shfaqet nga mesi i shekullit XII si dinasti e Nemanjave në Rashë (Rasien), vasale e Bizantit ose edhe e Mbretërisë Bullgare të Borisit dhe të Simenonit më vonë pasi që të ketë

depërtuar nga pjesa qendrore e Bosnjes, Zaxhlumia dhe Travunria ku e kishte gjenezën organizimi i parë fisnor i tyre për t'u forcuar duke kaluar nëpër Diokle (Zetë). “Shteti mesjetar”, ashtu si paraqitet nga një pjesë e madhe e historianëve serbë dhe e historiografisë serbe, në një shpërputhje thujtë të papajftueshme midis faktorit gjeografik (hapësirës) dhe atij etnik,<sup>362</sup> është konstrukt i shekullit nëntëmbëdhjetë, veçmas pas shfaqjes së “Naçertanjës” së Garashaninit. Andaj, titujt “zhupanë”, “sevastokrat”, “despot” dhe “princa”, “mbretër” e madje edhe “perandor”, siç i atribuohet jo rrallë Stefan Dushanit, që ndeshen nëpër dokumentet kishtarë ortodokse, ose ato të Selisë së Shenjtë (origjina e të cilit, të shumtën lidhet me atë tribale),<sup>363</sup> ndonëse të sajua për qëllime kishtarë dhe të vendosura nëpër “kronika autentike” për t'u ndikuar njëanshëm historia në përputhje me pretendimet hegjemoniste sllavo-ortodokse,<sup>364</sup> kanë qenë të hierarkisë së

---

<sup>362</sup>Me shpërputhjen midis faktorit gjeografik (hapësirës) dhe atij etnik si dhe raportet e tyre në përcaktimin e vendit të serbëve në histori dhe të shtetit të tyre sipas pretendimeve se duhet parë në mesjetë, merret intensivisht historiani Relja Novaković në studimin tij kritik “*Где се налази Србија од VII до XII века*“ (Ku gjendet Serbia nga shekulli VII deri në të XII), Београд, 1991. Duke u mbështetur mbi dy dokumente themelore, Kronikën e Perandorit Konstantin Porphyrogenitit: “*De Administrando imperio*” dhe Kronikën e Mario Orbinit “*Il Regno degli Slavi hoggi corrottament detti Slavoni*”, 1601, Novaković nxjerr përfundimin se amza e organizimit shoqëror serb gjendet në Bosnje (Zahumle dhe Travurni), ndërsa shtrirja e tyre në pjesën lindore, deri në Rashë, ku edhe shfaqet dinastia e Nemanjajve, janë pjesë e këtij zhvillimi dhe assesi epiqendër. Me këtë rast, Novaković nxjerr përfundimin se kronika e Porphyrogenitit nuk e sqaron fare shtetësinë serbe dhe as etninë e saj, siç shfaqet te shumica e historianëve serbë kuturu dhe e mitzuar, por përkundrazi e lë të varur dhe me shumë paqartësi, veçmas në raport me faktorët e tjetër të kohës, siç janë etnitë dhe popujt shtetformues të Bizantit (Ilirët, Thrakasit, Grekët), me të cilët ata ranë në kontakt pars vendosjes së tyre nga shekujt VII-X. Novaković pranon se telasheve me përcaktimin e vendit të Serbëve dhe të Serbisë në historinë mesjetare u ka nxjerr rishkrimi dhe falsifikimi i Kronikës së Porphyrogenitit, sidomos ai i rishkrimit të kapitullit 30 nga autorë të panjohur si dhe falsifikimi i Kronikës së Mario Orbinit, në të cilën mbështeten thujtë shumica e historianëve serbë dhe të huaj kur flasin për “shtetin mesjetar serb”, i cili, rëndom amputohet në kuadër të emërtimit “Slavonija”, që e përmend Porphyrogeniti, të përgjithësuar, e ku pastaj pa ndonjë argumentim shkencor, kroatët shohin shtetin kroat (Kroacinë), serbët shtetin serb (Serbinë) dhe boshnjakët shtetin boshnjak (Bosnën)!

<sup>363</sup> Shih: Constantinus, Porphyrogenitus: “*Corpus scriptorum Historiaia Byzantinae*”, vol. III, Bonnae MDCCXI.

<sup>364</sup> Falsifikimin e dokumenteve kishtarë si dhe sajimin e tyre në përputhje me nevojat e kishës, veçmas të atyre të kishës ortodokse e pranojnë shumë autorë, të cilët i marrin me rezervë ato dhe madje i vlerësojnë në mënyrë kritike. Ndër ta është edhe historiani i njohur Konstantin Jiriček, autor i “Historisë së serbëve”, në dy vëllime, të botuar për herë të parë në gjermanisht në Gotha në vitin 1918, ku ai shpreh mosbesim ndaj shumë burimeve kishtarë, madje edhe ndaj atyre në gjuhën latine, siç është “*Gesta regum Sclavorum*” e njohur si “*Letopis popa Dukljanina*” e vitit 1601 ku fjala “*rex*” në latinisht, që, sipas hierarkisë kishtarë, ka të bëjë me kryeparin e ipeshkvisë, në kroatisht përkthehet ashtu si duhet - “*gospodin*”, ndërsa në serbisht “*kralj*” (mbret). Mungesën e dokumenteve autentike të kishave ortodokse sllave, veçmas atyre të Deçanit, Pejës dhe të Prizrenit, të cilat shfaqen si referenca të pashmangshme kur bëhet fjalë për “shtetin mesjetar serb” në Kosovë, si dhe sajimin e disa syresh “në përputhje me origjinale”, (edhe pse nuk dihet se cilat janë ato origjinale kur ato nuk ekzistojnë), e pranon edhe Jastrebov në veprën “*Historia e kishës serbe*”, të botuar në vitin 1879. Por, falsifikimi më flagrant i fakteve historike me anën e të cilave duhej të dëshmohej “shtetësia serbe” në mesjetë bëhet nga Akademia Serbe e Shkencave (SANU) me anën e pasqyrit të dokumenteve bizantine në përputhje me këtë koncept antishkencor. Të kësaj natyre janë gjashtë botimet e SANU nga vitet e pesëdhjeta deri në

brendshme të Bizantit, që janë ndarë në përputhje me shkallën e vetëqeverisjeve, të autonomive apo të formave të tjera që kanë shkuar deri te vasalitetet. Edhe faktori kishë (lindor apo perëndimor) ishte përherë i pranishëm dhe pashmangshëm bekonte këta tituj sipas kriterëve të veta dhe në përputhje me interesat kishtarë, të cilat rëndom lidheshin me forcimin e peshkopatave të caktuara, që si të tilla mund të bëheshin vetëm karshi despotëve vendorë me tituj sa më të lartë perandorak.

Të kësaj natyre madje janë edhe titujt e shumtë dhe të shpeshtë “*rex*” (mbret), “*regum*” (mbretëri) në latinisht, që hasen në dokumentet dhe burimet e ndryshme latine, kryesisht të nxjerra nga Vatikani dhe të bartura nëpër karta të ndryshme “mbretërore”, ose të përkthyer nga kronikat bizantine, siç është edhe vepra e perandorit Porphyrogentit (Porfirogenti), me pasazhe të tëra “të plotësuar”, të rishkruar e të falsifikuar në kohë të ndryshe,<sup>365</sup> dhe ajo e M. Orbinit<sup>366</sup>, të keqpërdorura skajshmërisht për këto qëllime, por që edhe përkundër këtyre falsifikimeve të të dhënave fundamentale rreth sllavëve (sidomos serbëve), mund të shihet fare qartë se titulli “*rex*” i interpretuar serbisht si “*kralj*” (mbret) është një titull kishtar për “*zotëri-i parë i fisit*”, që në kroatisht përkthehet si “*gospodar-gospodin*” që iu kanë dhënë familjeve dhe të parëve të tyre sapo kanë pranuar krishterimin dhe iu janë nënshtuar rregullave kishtarë, të cilat, njëherësh, kanë paraqitur edhe njëfarë pushteti vendor. Ky keqpërdorim i terminologjisë kishtarë “*rex*” (zot shtëpie), për qëllime politike ka derivuar në “*regia*” (krahinë) e deri te “*regnum*” (mbretëri).

---

ato të shtatëdhjeta të shekullit të kaluar “*Vizantijski Izvori za Istoriju Naroda Jugoslavije*”, ku nga dokumentet burimore bizantine, të dhënat historike interpretohen në përputhje me doktrinat serbomëdha. Kështu *Tribalët*, një popull antik dardano-ilir konvertrohen në *serbë!* Në serbë kthehen edhe *Dakët*, pa ngurruar këtu që edhe *Dalmatët* të përvehtësohen. Kështu, këto gjashtë vëllime voluminoze paraqesin burimin kryesor të falsifikimit të historisë së Bizantit, të cilat citohen me të madhe jo vetëm nga shumica e autorëve serbë, por edhe nga shumë të huaj, të cilët, në mungesë të një kundërpërgjigje të argumentuar shkencore, ato i marrin si referenca “shkencore”. Për fat të keq, si të tilla, ato ndikojnë një pjesë të mirë të historiografisë zyrtare në Tiranë dhe Prishtinë, ku në tërësi, gjatë emërtimeve të objekteve kishtarë si dhe të formacioneve shoqërore dhe politike (zhupanive, despotëve, feudalëve), ruhet gjuha e historiografisë hegjemoniste serbe. Kështu, despotet dhe zhupanët (Nemanjiqët), ndonëse nga shumica e autorëve bizantinë (Chalcocondylas, Leonici: “*Historiarum Demonstrationes*”, ed. E. Darco, Budapestini, 1922, Ducas: “*Historia Turco-Byzantina 1341-1462*, ed. V. Grecu, Bucharest 1958), quhen princa *Tribalë*, ndërsa vendi *Tribalia*, nga historianët shqiptarë cilësohen “mbretër” dhe perandor madje, siç ngjet me Dushanin, ndërsa zhupanija “*Rascia*”, ose “*Rassia*”, “*Rasa*”, thuhet vazhdimisht konvertohet në “Serbi”, “Mbretëri serbe”!

<sup>365</sup> Shih: Constantinus Porphyrogenitus: “*Corpus scriptorum Historiae Byzantinae*”, vol. III, Bonnae MDCCXI, ku në përshkrimin e popujve “paganë”, në pjesën e Ilirikut, për serbët thotë “serbët në gjuhën e romejve quhen robër (σροχοι), rrobat e tyre “serbula” (σερβυλα) dhe ata që i bartin “cerbiljani” (τςερβυλιοι). Ata e morën emrin serbë pasi që nga perandori romej u kthyen në robër”. Shih, faqe 150.

<sup>366</sup> Orbini, Mauro: “*Il Regno degli Slavi hoggicarrottament detti sclavoni*”, 1601.

Andaj, nuk është për t'u habitur pse sot janë në qarkullim shumë e shumë këso kartash (bula) kishtare në versione të ndryshme titujsh, të cilat sjellin huti por edhe mjegullim të qëllimshëm nga shekulli XVIII e këndej kur e njëjta kartë (bulë) shfaqet me gjashtë versione, siç është ajo e despotit Urosh III dhe tri të tjera që kanë të bëjnë me “kurorëzimet” e despotit Stefan Dushan “mbret”. Ndonëse ato kanë qenë vetëm “tapi” pronësore kishtare, për t'i ruajtur feudet e caktuara dhe pronat e tyre në kuadër të qeverisjes fisnore dhe vendore në raport me pushtetin qendror të Bizantit, të cilat kanë qenë fare të natyrshme dhe të pashmangshme. Me anën e tyre janë ndërtuar raportet e njohura të vasaliteteve me bujarët, zhupanët dhe despotët në pjesët e ndryshme të Perandorisë, siç është siguruar më mirë edhe vjelja e taksave, prej të cilëve kanë nxjerrë dobi të mirë edhe feudalët, zhupanët dhe të tjerët nga pushteti vendor, ku ata kanë pasur një fuqi të konsiderueshme dhe jo rrallë, në kohë të caktuara të dobësimit të pushtetit qendror, edhe jashtë ndonjë rebelimi të shpallur, janë sjellë edhe si të pavarur, gjë që në kronikat e kishave vendore shfaqet e tilla janë shënuar si “shtete autonome”.

Edhe pse kësaj çështje do t'i kushtohet një vëmendje më e madhe në vijim, sepse ajo prek drejtpërdrejt raportet historike midis pasardhësve të Ilirëve dhe Dardanëve Arbërve (më vonë Shqiptarëve) dhe Sllavëve në përgjithësi nga Mesjeta e këndej sidomos në rrethanat e ortodoksisë kur pushteti feudal është përcaktuar nga kjo përkatësi mbi të cilën më vonë do të spekulohet me identitetet nacionale (edhe pse dihet se në atë kohë nuk ka pasur të tillë pos konfeksional i lidhur me kishën lindore ose atë perëndimore), megjithatë duhet thënë se qysh nga fërkimet e para me fiset barbare nga veriu (fillimisht me Hunët, pastaj me Avarët e Gotët dhe së voni edhe me Sllavët), Iliro-Dardanët brenda etnisë së tyre, pra në Ilirik, patën një rol të dyfishtë: në njërën anë të mbrojtësve besnikë të hapësirës perandorake, dhe tjetrën anë të mbrojtësve të saj nga depërtimet e fiseve shkatërruese, meqë kështu mbronin vendet e tyre, të cilat ktheheshin në pre të parë të pushtuesve. Po ashtu, në këtë luftë të gjatë e të ashpër, mbronin edhe qytetërimin e krishterë, të cilin ata e kishin pranuar ndër të parët dhe statusi i tyre i qytetarisë bizantine (*romaios*) ishte i lidhur me të.

Në këtë rol të dyfishtë, Iliro-Dardanët, kishin edhe interesat e tyre, meqë në njërën anë, që nga koha e perandorit me prejardhje ilire, Dioklecianit e këndej, pas reformave të tij të njohura, kur do të krijohet provinca e Ilirikut si pjesë lindore e Perandorisë së Romës, atë e shihnin si perandori të tyre, që duhej mbrojtur me çdo kusht, sepse ashtu mbronin edhe statusin e tyre të lartë shoqëror, politik dhe kulturor si “*romaios*” që kishin arritur nga shpallja e kodikut të perandorit

Karakalla të qytetarëve të lirë. Ndërsa në tjetrën anë, me reformat e njohura kish-tare të Justinianit, kur qendra kish-tare e Ilirikut kaloi nga Thessaloniki në Justiniana Prima, pra në Dardani dhe ajo lidhej drejtpërdrejt me Selinë e Shenjtë. Pas përplasjeve të njohura midis rrymave të shumta kish-tare (arianizmit dhe të tjerave) dhe kokëçarjeve që sollën ato, kisha perëndimore kthehet në pjesë të identitetit të tyre shpirtëror, që njëherësh plotësonte atë perandorak, pra shtetëror.

Se nuk ishte kjo çështje formale as e gjeografisë politike, siç shihet ndonjëherë, por ishte një përkatësi shpirtërore që Iliro-Dardanët si bizantinë të mirëfilltë njëherësh shfaqnin identitetin e tyre autokton, këtë më së miri e pasqyron e ashtu-quajtura krizë e ikonave, e cila për më shumë se një shekull kthehet në një luftë të brendshme fetare por edhe politike midis Lindjes dhe Perëndimit, që për pasojë pati zhvillimet që çuan te ndarja përfundimtare e kishës në vitin 1054 në ritin lindor (ortodoks) dhe atë perëndimor (latin). Kjo ndarje që kaloi mbi trungun e etnisë së tyre, më së shumti i qëlloi ata. Sepse ajo vijë do të kthehet edhe në vijë të ndarjeve politike dhe shpirtërore pa përjashtuar aty edhe përmasat që pas pak (shfaqja e kryqëzatave dhe pas tyre pushtimet osmane), do të shkojnë edhe deri te ato të ndeshjes së qytetërimeve me pasoja të rënda për Arbërorët.

Siç dihet, kisha dardane në përbërje të hapësirës administrative të Ilirikut, me ndonjë përjashtim të vogël (siç ishte rasti i peshkopatës së Durrësit e cila më shumë pretendonte kah patrikana e Kostandinopojës nga se perandori Anastas ishte nga ky qytet), në vazhdimësi mbrojti pikëpamjet e Selisë së Shenjtë, pra rreshtohet në mbrojtje të ithtarëve të ikonave. Meqë në këtë mënyrë u mbetej besnik koncepteve perëndimore në krijimtari, me të cilat ajo identifikohet si nismëtare e përhapjes së krishterimit dhe në tjetrën anë mund t'u kundërviheshin përpjekjeve sektare që vinin nga Lindja, të cilat rëndom pranoheshin nga paganët Sllavët dhe barbarët e tjerë.

Sa i përket çështjes së parë, pra të mbrojtjes së Perandorisë si pjesë të vendit të tyre dhe të identifikimit të plotë të interesave të tyre me ato perandorake, me këtë sfidë Iliro-Dardanët ballafaqohen ndër të parët qysh në vitin 376 kur Gotët ishin lejuar të kalonin Danubin, që t'u shpëtonin Hunëve dhe ata do të vendosen në një rrip toke midis Rodopeve në Lindje dhe Timokut në Perëndim, që në të vërtetë paraqiste njëfarë vije ndarëse midis Dardanëve dhe Trakasve. Këtë vijë e përmend edhe Herodoti,<sup>367</sup> po edhe autorë të tjerë antikë, që njihet si Traki, identiteti etnik i të cilëve duhet parë i lidhur me atë ilir-dardan nga trangu i përbashkët pellazg.

---

<sup>367</sup> "Historiae", Libri V/15.

Por, Gotët nuk ishin në gjendje që të përmbushnin detyrimet e marra të mbrojtësit nga Hunët, ngaqë të udhëhequr nga Atila, Hunët thyen kordonin got dhe në vitet 441-442 shkretuan një pjesë të mirë të Ilirikut. Gjatë sulmeve të tyre shkatërruan shtatëdhjetë qytete dhe detyruan Perandorinë e Lindjes që t'u paguante haraç të rëndë. Për përmasat e këtyre rrënimeve flasin shumë autorë antikë, të cilat i quajnë të papara për nga përmasat dhe pasojat e rënda që shkaktuan.<sup>368</sup>

Pas fushatave të Hunëve, të cilat morën fund me fushatën e vitit 447 kur Atila edhe një herë shkretoi Ilirikun prej nga ata do të kalojnë në Itali dhe atje pas marrëveshjes me Romën do të marrë fund koha e tyre, Gotët do të kthehen në faktorë përbërës të Perandorisë, çastin që vendosën të mbeten në të dhe do t'i nënshtrohen lojalitetit perandorak. Pjesëmarrja në ushtri si dhe gatishmëria që të përfshiheshin në luftimet mbrojtëse kundër sulmeve të fiseve barbare që vinin nga veriu dhe veri-lindja, bëri që ata të shpërbleheshin me toka pjellore, të cilat fillimisht shtriheshin rrjedhës së Danubit kah Deti i Zi për t'u zgjeruar pas pak me ato në drejtim të Panonisë, ku shtriheshin Ilirët. Në këtë mënyrë, brenda një kohe të shkurtër, nga Bizanti i cili ishte i interesuar që të forcohej në pjesët perëndimore, atyre iu lejua mbretëria Ostrogote, në krye me Teodorikun, i cili kishte kaluar rininë në oborin e Kostandinopojës në mbrojtje të perandorit dhe vlerësohej si përkrahës i "vijës së mesme", pra i baraspeshës Lindje-Perëndim.<sup>369</sup>

Nga shpallja e tij mbret i Ostrogotëve më 489 Teodoriku zgjeroi "mbretërinë" e tij në Perëndim kryesisht në dëm të Ilirikut prej nga ia doli që të depërtojë edhe në Italinë e Veriut dhe në Gali dhe prej andej, ata që dikur ishin pranuar në Perandori që ta mbronin atë, si të pushtetshëm dhe me pretendimin se atë duhej forcuar dhe zgjeruar edhe më tej në të dy anët, do të kthehen në një kërcënim të ri të saj.

Edhe pse burimet historike flasin për qëndrimin e Gotëve në Ilirik (nga viti 459-535) dhe për pasojat që kishte, megjithatë do të shihet se ata nuk do të jenë në gjendje që, si mendohej, të kthehen "në digë" kundër Hunëve, ekspeditat e të cilëve do të vazhdojnë herë pas herë, e as në stabilizues të gjendjes. Më tepër se mbrojtës nga Hunët, me shtrirjen dhe qëndrimin e tyre në perandori, Gotët do të kthehen në pararendës të realiteteve të reja me të cilat do të përballet pjesa perëndimore e Perandorisë, gjithnjë në kurriz të Ilirikut, me çka do të fillojë edhe një konflikt i hapur i Perandorisë me ta, që përgjigjen e fundit do t'ia japë perandori Justinian.

Por a ishte ky kërcënim i papritur, që "nga dika" edhe mund të ishte paraparë? Apo ishte pjesë e një zhvillimi të pandalshëm, që do të shfaqet pse Iliriku

<sup>368</sup> Jacquwes, Edwin: "Shqiptarët", Tiranë, 2002, faqe 171.

<sup>369</sup> Po aty.

edhe si provincë e re e shpallur nga Iliri Dioklecian dhe e reformuar nga Dardani Konstantini i Madh nuk do të jetë në gjendje që të kthehej në mburojë kundër depërtimeve të barbarëve, siç mendohej, edhe përkundër shpenzimeve të mëdha që ishin bërë në gjithë sistemin e fortifikimit që kapte pjesën veriore të Ilirikut (Danubin) si dhe Dardaninë?

Në të vërtetë perandorët reformatore: Diokleciani, Konstantini i Madh dhe së fundi Justiniani, kishin parasysh rrezikun nga barbarët në Veri, por midis tyre sikur bënin dallime, se cilët do të mund të jenë më pak të rrezikshëm, e cilët madje të dobishëm, në rrethanat kur Perandoria kishte nevojë jo vetëm për ushtarë, por edhe për fuqi punëtore për të punuar tokat, sidomos në pjesët e skajshme. Fuqia punëtore bëhej edhe më e madhe sa më shumë që perandoria pas reformave të filluara formonte një unitet më të qartë ekonomik, i cili nëpërmes Mesdheut ndërlidhte tri kontinente. Në këto rrethana barbarët shfaqnin një kërcënim të madh, por edhe një mundësi që t'i jepnin gjak të ri Perandorisë.

Në përputhje me këtë hesap ishte Perandori Valens ndër të parët që lejoi Gotët të vendoseshin në pjesët e Trakisë dhe të Ilirikut, meqë ata i shihte me sy tjetër nga Hunët, të cilët vinin nga stepat e Mongolisë dhe gjatë sulmeve të tyre shfaqnin vullnet vetëm për rrënim dhe plaçkitje. Pse Gotët shiheshin me sy tjetër, kjo gjithsesi kishte edhe arsyt e veta që kishin të bënin me prirjet e Gjermanëve orientale për krishterimin. Të zbritur nga brigjet e Detit të Zi, Gotët kishin rënë në kontakte me kultin e vjetër greko-lindor të Grekëve të Sarmartëve të Krimesë, ku kishin mësuar artin zbukurues të argjendarisë ornamentale, të cilën më vonë do ta përhapin nëpër Europë nën emrin “barbari”.<sup>370</sup>

Si barbarë me prirje për krishterimin, Ostrogotët të ndjekur nga Hunët do të hidhen në Panoni, pra në Ilirik, ndërsa Vizigotët në pjesën e Trakisë nën Danub. Ishte viti 276 kur ata përgjithmonë lanë vendet e tyre dhe u vendosën në pjesët lindore të Perandorisë. Me hyrjen e tyre, një trup i huaj kishte hyrë në Perandori, që si do të shihet duke hyrë nga Lindja pak nga pak do të zhvendosen drejt Perëndimit, por që këtë do ta bëjnë pasi që të kenë matur forcën e tyre pikërisht aty ku mendohej se do ta mbronin Perandorinë. Pra në Traki dhe pranë mureve të Kostandinopojës, kur gjatë një rebelimi ia kishin dalë të vrisnin edhe perandorin Valens në maj të vitit 378. Pas kësaj fitoreje, Gotët e trimëruar, por gjithnjë me statusin e barbarëve (me ligjin e Velenianit dhe të Valensit në vitin 370 dhe 375 nën peshën e dënimit me vdekje ndalohej martesat ndërmjet Romakëve dhe bar-

---

<sup>370</sup> Pirenne, Henri: “*Muhamedi dhe Karli i Madh*”, Tiranë, faqe 19.

barëve), nga Lindja do të sulmojnë tokat e Ilirikut drejt Jugut, që pasi të kenë plaçkitur shumë qytete të Dardanisë dhe të Thesalisë të arrijnë edhe deri në Athinë dhe Peloponez dhe prej andej do të hedhen edhe në Epir dhe me siguri se po mos të ishte ndërhyrja e perandorit Arkadi, që me ta të lidhte marrëveshje për të mbetur në Perandori me një status të veçantë “federativ”, do të vazhdonin me shkatërrime të mëtejshme.

Marrëveshja e Arkadiusit me Gotët e cila parashihte që ata të vendoseshin në provincën e Ilirikut (në pjesën perëndimore në drejtim të Italisë). Me këtë rast, prijësit të tyre Alariku nga ana e perandorit iu dha titulli “*Magister militum per Illyricum*”. Kjo bëri që Gotët të ndjeheshin jo vetëm pronarë të rinj të një pjese të mirë të Ilirikut, që u ishte dhuruar si kundërshpërblim që ata në atë pjesë të ktheheshin në mbrojtës të saj, por edhe të vetëmandatuar që të zgjeroheshin më këndej atë që tashmë e shihnin si mbretëri gote, mbase edhe me pretendimin që një ditë Perandoria Romake të kthehej në Perandori Gote. Me të tilla veprime Alariku, i cili tashmë kishte plaçkitur edhe Romën dhe prapë i ishte drejtuar Veriut, sërish do ta qëllojë Ilirikun në veri, meqë kishte mendjen që të lidhte hapësirat e “Romanisë” me ato të “Gotisë”. Këtë rrugë do ta ndjekë edhe pasardhësi i Alarikut, Athaulfi, i cili kishte marrë drejtimin e Gotëve pas vdekjes së Alarikut më 410. Rrënimet e Gotëve si dhe matjet dhe çmatjet e vazhdueshme të perandorëve që me ta të bëheshin hesape të ndryshme, veçmas kur rrezikoheshin nga Hunët, siç do të jetë rasti me sulmet e Atilës dhe plaçkitjet e tij të njohura nga viti 447 deri më 451, të cilat do të fillojnë nga Trakia e deri në Termopile, prej nga pastaj do të kthehet edhe kundër Galisë dhe prej atje do të kapërcejë edhe Rajnën (Rinin) duke shkatërruar gjithçka gjenin përpara deri në Laur. Natyrisht se do të jetë Aiteusi i mbështetur nga Gjermanët, Frankët, Burgondët dhe Vizigotët që do ta mundë Atilën, i cili pas dy vitesh do të gjejë vdekjen në këtë luftë e cila do të zhvillohet në Troja të Francës. Me këtë fitore Gotët do të kthehen në zotërues të pjesës Perëndimore të Perandorisë, ndërsa aleatët e tyre, fiset gjermane, bashkë-pjesëmarrës në ndarjen e pushtetit të copëtuar në shumë pjesë, gjë që në të vërtetë, në atë kohë në Perëndim nuk kishte pasur veçse një mozaik mbretërisht barbarë: Ostrogotë në Itali, Vandalë në Afrikë, Suev në Gali, Vizigotë në Spanjë dhe deri në jug të lumit Laur, si dhe Burgondët në luginën e Rajnës.

Gotët në Ilirik u shfaqën në vitin 459. Në krye të tyre ishte mbreti Teodorik, i cili u vendos në Durrachium. Prej hapësirës ilire Gotët do të ndër marrin fushata të herë pas hershme ushtarake në drejtim të Peloponezit, por edhe në brigjeve italiane. Fushatave të tyre nuk do t’u shpëtojnë as Thrakia dhe Epiri, ku Gotët,



për t'u furnizuar, plaçkitnin pareshtur. Gjatë këtyre fushatave plaçkitëse më së shumti pësuan Nikopoja, Onherzmi dhe qytetet e tjera deri në Dodonë.<sup>371</sup>

Përqendrimi i Gotëve në Ilirik si dhe veprimi i tyre nga kjo pikë, nuk ishte i rastit e as pjellë e rrethanave të caktuara, siç mund të dukeshin ato kur ata u zunë në luftime thuajse të papritura me Avarët, të cilët depërtuan në Itali dhe atje shkretuan pjesën e saj më të madhe, prej nga Teodorikut doemos i duhej një përgjigje. Përqendrimi i Gotëve në Ilirik atyre ua mundësonte mbikëqyrjen e duhur për të ushtruar pushtet në të tri drejtimet njëherësh: kah lindja, në Mesdhe dhe drejt Perëndimit. Ata, tashmë, kishin në dorë jo vetëm hapësirën, që e mbikëqyrnin, por edhe mundësinë që të mbikëqyrnin edhe ngjarjet shoqërore dhe politike në të dy anët e Perandorisë me pretendimin që ato t'i ndikonin dhe t'i drejtonin madje.

Natyrisht, se do të jetë perandori dardan, Justiniani I, i cili ushtarakisht do të zgjidhë njëherë e mirë çështjen e kërcënimit got, kur në vitin 552, komandanti i tij Narseti, pas një disfate të thellë që ua shkaktoi, i dha fund Mbretërisë Ostrogote prej nga ata do të zhduken fare si komb nga historia.

Fundi i Gotëve, ashtu si ndodhi, Ilirikut ia ktheu për pak qetësinë e brendshme, por jo edhe ardhmërinë e sigurt që e kishte dëshiruar perandori Justinian kur atij ia kishte paraparë rolin e urës midis Perëndimit dhe Lindjes. Ishte pikërisht kërcënimi i fiseve sllave nga veriu, si dhe depërtimet e tyre të dhunshme të njëpasnjëshme përtej Danubit, që filluan ta çrregullojnë jo vetëm konceptin për Ilirikun si provincë kryesore të Perandorisë në pjesën lindore, por edhe për ruajtjen e baraspeshës së brendshme shoqërore dhe politike të Perandorisë, e cila po ashtu në këtë pjesë sfidohej nga lindja.

Pas vdekjes së Justinianit dhe krizave që do të kalojë Perandoria gjatë qeverisjes së Justinit dhe Mauricit e deri te ajo e Heraklit, nga ky i fundit trysnia e fiseve sllave do të shfrytëzohet, që Sllavët të përdorëshin si faktor “qetësues” me çka atyre do t'u hapen dyert që më vonë, nga shekulli IX e këndej të kthehen edhe në faktor dominues dhe madje edhe baraspeshues i Perandorisë, siç do të ndodhë nga shekulli IX e këndej, kur ata do të sillen në përputhje me aleancat e ndryshme lindje-perëndim, me anën e të cilave do të përshpejtohet dobësimi dhe shkatërrimin i saj. Duke iu lejuar atyre vendosja në Ilirik, me anën e kolonëve Sllavë, Perandoria Lindore fitonte mundësi që të hiqte rrezikun pers në Lindje, veprim ky që si dihet, fund e krye do të shkojë në dëm të Iliro-Dardanëve si dhe të dobësimit të pjesës perëndimore të Perandorisë në raport me Kostandinopojën,

---

<sup>371</sup> Shih: Ducas. M: “*Historia Byzantina*”, Bonnae, 1834; Schreiner, P: “*Die Byzantuischen Kleinkroniken*”, I,II,III, Wien 1975-1979;Feveriale, Zhan Klod: “*Historia e Shqipërisë*”, Tiranë 2004, faqe 110.

kur do t'u hapet rruga aleancave të njohura midis kishës lindore me Heraklin për ta dobësuar apo larguar fare ndikimin e Perëndimit. Kjo do të pasqyrohet më së miri me futjen e gjuhës greke si gjuhë zyrtare në Lindje dhe si gjuhë liturgjike, me çka Iliriku, që ishte nën juridiksionin administrativ të Lindjes dhe atë kishtar të Selisë së Shenjtë, do të silltet përballë një gjendje tepër të rëndë sipër së cilës do të kalojnë thyerjet e brendshme dhe të jashtme, të cilat do të çojnë te zhvillimet e njohura në njërin anë të shembjes së pjesës Perëndimore të Perandorisë dhe në tjetrën anë të ndarjes së kishave, me ç'rast pjesa më e madhe e Ilirikut do t'i takojë juridiksionit kishtar të Kostandinopojës e me këtë edhe nga pikëpamja shoqërore, kulturore dhe politike t'i nënshtrohet Lindjes, ku si do të shihet, gjuha e kishave (krahas greqishtes, në pjesën qendrore, nga shekulli XI edhe sllavishtja e vjetër), do të jetë përcaktuese jo vetëm në planin shpirtëror, por edhe atë kulturor dhe shoqëror në përgjithësi, ngaqë ato do të ndikojnë që identitetet e caktuara kishtarë të përkthehen në aso etnike madje edhe shoqërore dhe politike, mbi të cilat më vonë (në shekujt XVIII dhe XIX), do të mbështeten edhe lëvizjet kom-bëtare.<sup>372</sup>

Por, kush ishin Sllavët dhe prej nga vinin fiset të cilat do të kthehen në faktorë të rëndësishëm me të cilët Iliro-Dardanët dhe dega tyre Tribalët,<sup>373</sup> më vonë edhe pasardhësit e tyre Arbrit dhe Shqiptarët, do të kenë fërkime, konflikte madje edhe luftëra të ashpra, pa përjashtuar këtu edhe bashkëjetesën e brishtë në të njëjtat hapësira?

Fillimisht duhet thënë se Sllavët në kronikat perandorake shfaqen të mjugulluar diku nga shekulli V i erës sonë në saje të përzierjes me Avarët dhe popujt e tjerë nomadë nga Azia Qendrore, që herë pas herë sulmonin pjesët perëndimore dhe shkretotin nga kalonin dhe prapë ktheheshin në stepat e tyre. Disa burime historike bëjnë të ditur se toka mëmë e Sllavëve pat qenë djerrina e lumit Pipet, në veri të qytetit të sotëm ukrainas Kievit.<sup>374</sup>

---

<sup>372</sup>Shih: Janin, R: "*Constantinople byzantine*", Paris, 1964.

<sup>373</sup>Për *Tribalët* si fis i njohur antik flasin shumë autorë antikë, duke ua përcaktuar vendin në veri, në hapësirën midis Ilirëve dhe Trakëve dhe në afërsi me Dardanët. Chalkonkondili thotë *se janë degë ilire*. I quan popull më i forët në botë. Ky kronist i kohës thotë se Tribalët dhe Mizet flasin të njëjtën gjuhë me Ilirët, ndërsa emërtimet i kanë nga shtrirja gjeografike (Shih: Chalconcandylae, Leonici: "*Historiarum Demonstrationes*", Budapestini 1922, faqe 30 dhe 280-282.) Për lidhjen e Tribalëve me Ilirët flet edhe Cristobulos. Kronisti bizantin vendet Tribale i sheh në qendrën e Ilirikut, rrjedhës së Moravës deri në Danub në veri, ndërsa në lindje të kufizur me Dakët, ndërsa në jug me Pajonët. (Shih: Cristobulos: "*Imbriotae Historiae*", ed. D.R. Reinsch, Berlin, New York 1983, faqe: 27,85, 95, 97-98 dhe 175).

<sup>374</sup> Më gjerësisht shih: Ostrogorski, Georgije: "*Istorija Vizantije*", Beograd; Iorga, Nicolae: "*Bizanti pas Bizantit*", Tiranë 2009.

Por, në këtë bredhje të pikënisjes së tyre, ka edhe shumë e shumë njoftime të tjera që strofka e tyre e parë nuk mund të ishte rrafshina, por ndonjë vend malor, ose edhe stepat, të cilat prodhojnë mentalitetet e nomadëve, e ku bëhet fjalë për stepet nga Karpatet deri në Ural, ku ishin të vendosur Finët të cilët fillimisht shtriheshin drejt jug-perëndimit. Nga disa burime të vjetra, megjithatë bëhet e ditur se Sllavët e mirëfilltë në pjesën midis Karpateve dhe Uralit, për fqinjë në perëndim kishin Gjermanët, në veri Lituanezët, ndërsa në juglindje në stepat pa pyje fqinjë kishin popujt iranianë, ndërsa në jug, në Karpate Trakët, më vonë të përzier me disa fise kelte. Lirimini e parë nga rrethimi i popujve fqinjë Sllavët e ndërmorën në drejtim të Lindjes mbi Dnjepër, ndërsa një tjetër drejtimin e kishte nga Perëndimi, ku gjuha e Sllavëve të Elbës ka ruajtur forma tingujsh shumë të lashta.<sup>375</sup>

Mbi këtë supozim Jeriçek mbështet qëndrimin se Romakët dhe Sllavët u njohën përmes ndërmjetësismit të Gjermanëve dhe se nga Romakët Sllavët quheshin *venedi* (*Οβενδα*), siç quheshin në mesjetë në Gjermani *Vinidi*. Si *Vened* ata përmenden te Plini si popull në lindje të Weichselit, që si tablo gjeografike e lindjes nga shënimet e Tacitusit (Tacitit) kur "*Venedet*" përmenden karshi Gjermanëve, Dakëve, Sarmatëve, Esierëve (Lituanezëve) dhe Finëve. Kjo, megjithatë, duhet të merret me rezervë, ngaqë krahas prejardhjes dhe kuptimi i të cilit nuk është i njohur, ky emër nuk njihet nga vetë Sllavët dhe nuk ishte kurrë në përdorim,<sup>376</sup> siç nuk e njihnin as Bizantinët emrin "*Vened*", por i referoheshin emrit *Slovenin* (në shumës *Slovene*), siç e quanin veten Sllavët. Kështu, nga shekulli VI Grekët i quanin Σκλαβμοι (lexohej *Sklavini*), romanët *Sclaveni*, *Sclavini*, *Sclavi*), ndërsa nga sirianët dhe arabët quheshin *Sakalib*. Nga pikëpamja gjuhësore, kuptimi i temës, qëndron i errët.<sup>377</sup> Nga shumë interpretime, emërtimi më i përafërt për sllavët lidhet me atë romak *Sclaveni*, *Sclavinorii* – shërbëtor. Pra, për ata që kanë kryer shërbime, gjë që kjo përkon edhe me të vërtetën se lejimi i tyre nga perandori Heraklit në shekullin VII në Ilirik kishte këtë qëllim, që të *shërbenin* si mbrojtës nga barbarët në pjesët qendrore të gadishullit (në Bosnje), ku edhe ka filluar organizimi i tyre fisnor.<sup>378</sup>

<sup>375</sup> Po aty.

<sup>376</sup> Shih Miklosich "*Die Bildung von Ortsnamen aus Personennamen im Slawischen*", 1864, faqe 373

<sup>377</sup> Po aty.

<sup>378</sup> Rreth rreth organizimit të parë të fiseve sllave në Ilirik shih: Porphyrogentius, Constantinus: "*De Thema-tibus et de Administando Imperio*", Bonnae MDCCXL; Orbin M: "*Il Regno degli Slavi hoggicarrottament detti sclavoni*", 1601; Новаковић Рела: "*Где се налази Србија од VII до XII века*", Београд, 1981; Ћirković, Sima: "*Srbija u srednjem veku*", Beograd, 1995; Mišić, Siniša: "*Humska zemlja u srednjem veku*", Beograd, 1990; Dinić, Mihajlo: "*O nazivima srednjovekovne srpske države (Sklavonija, Srbija, Rashka)*", Beograd.

Sidoqoftë, pak më vonë, ata do të shihen, në grupe, duke u përhapur drejt maleve Karpate, prej nga do të fillojnë t'i drejtohen Perandorisë së Romës, nga shkaku i vetëm se në Traki dhe Iliri kushtet për jetë ishin më të mira dhe, si shumë fise nomade dhe barbare të Lindjes, që i drejtoheshin kësaj pjese. Edhe Sllavët e bënin atë, e që nuk përjashtohet mundësia që kjo lëvizje të jetë imponuar edhe nga trysnitë që atyre u vinin nga fiset tjera nomade nga Azia, që po ashtu lëviznin drejt Perëndimit.

Nga burime të ndryshme bizantine bëhet e ditur se para se t'u janë nënshtruar këtyre lëvizjeve drejt Perëndimit, në trojet e tyre të hershme merreshin me gjueti, e më vonë edhe me blegtori, por pa ndonjë prirje për bujqësi, të cilën, si duket do ta fitojnë pasi që të jenë vendosur në Ilirik dhe Traki, gjë që kërkimi i tokës së bukës, do të përcaktojë edhe lëvizjet e tyre të mëvonshme luginave të lumenjve dhe pjesëve të pëlleshme, të cilat të shumtën i zotëronin Ilirët.

Organizimi i tyre i brendshëm ishte fisnor dhe pa ndonjë lidhje të fortë. Përballë Avarëve, Mongolëve dhe popujve të tjerë nomadë nga Lindja, nuk kishin qenë në gjendje të bënin ndonjë qëndresë, pos t'u bashkoheshin gjatë fushatave të tyre, të përfitonin nga preja e tyre. Ndërkohë që pas tërheqjes ose disfatave të tyre, siç do të jenë ato të Avarëve dhe mongolëve nga Bizanti në shekujt V dhe VI, prapë do t'i kthehen organizimit të tyre fisnor, në mënyrë që pastaj, të pavarur grupe-grupe t'u drejtohen viseve perandorake, duke kaluar Danubin në pjesën veriore, ku fillimisht do të kenë punë me Trakët e më vonë edhe me Dardanët dhe Ilirët, pa përjashtuar edhe takime periferike me Grekët, të cilat nga disa autorë shihen që ata të kenë depërtuar edhe deri në Thessaloniki dhe Egje, ku do të pësojnë humbje, prej nga pastaj pas dy shekujsh do të shfaqen sërish. Nga të dhënat e shkapërderdhura dhe jo rrallë kundërthënëse, megjithatë mund të mësohet për shumë fise lindore, që herë pas herë, si mercenarë, për qëllime të caktuara viheshin në shërbim të Perandorisë, por që pastaj tërhiqeshin në pjesët përtej Danubit. Kronikat e ndryshme bizantine janë plot e përplotë me shënime të tilla, shumë prej të cilave, më vonë, veçmas nga shekulli XIX e këndej, janë shfrytëzuar për tablo të njëanshme të shkëputura, me të cilat dukshëm është mjeçulluar realiteti i atëhershëm historik.<sup>379</sup>

Të dhënat historike, megjithatë, depërtimet e para të Sllavëve në hapësirën perandorake, kryesisht në atë ilire-dardane-trake dhe më vonë në Ilirikum, kur edhe përfundimisht do të vendosen si kolonë nga perandori Herakli, i lidhin me

---

<sup>379</sup> "Spisi Dimitrija Katakuzena i Vladislava Gramatika", Beograd 1993

Avarët si dhe pjesëmarrjen në luftërat e shumta të këtij populli nomad turk, i cili, pasi që u sulmua nga turqit perëndimorë të Turkestanit dhe prej andej u dëbuan, me lëvizjet e tyre vunë në veprim thuajse të gjitha fiset sllave, por edhe ato hune dhe gote, në drejtim të Perandorisë dhe Europës Perëndimore. Në fushatën e tyre drejt Perëndimit Avarët shkatërruan Gepidët (567), dhe pasiqë Longobardët u tërhoqën drejt Italisë, ata u vendosën në një fushë, ku pak më shumë se një shekulli Atila i Hunëve kishte rezidencën.<sup>380</sup>

Në luftërat pushtuese të Avarëve kundër Perandorisë (572-591), kur Avarët do të kalojnë Danubin dhe, nga dy drejtime (ai verior do të depërtojnë në thellësi të Ilirikut) dhe ai jugor (kur do të arrijnë edhe në Thesalonikin) dhe pastaj në luftën përfundimtare drejt Kostandinopojës, ku në vitin 626 përfundimisht do të munden, Sllavët ishin pjesë e ushtrisë avare, edhe pse sa herë që Avarët arrinin ndonjë marrëveshje me Bizantinët, përpiqeshin t'i ndëshkonin ata, nëpërmes fushatave të egra, pas të cilave fiset sllave tërhiqeshin përtej Danubit, prej nga pritnin thirrjet e tjera që u drejtoheshin për t'u sulmuar perandoria.<sup>381</sup>

Sipas shumë burimeve bizantine, Sllavët, madje, për nga zullumi (plaçkitjet) ua kalonin Avarëve. Në Ilirik dhe Thraki, krahas rrënimeve të shumta, filluan edhe largimin me dhunë të vendësve nga trojet e tyre.<sup>382</sup>

Rreth zullumit sllav me shqetësim të madh flitet në shënimet e ipeshkvit sorian, Johanës nga Ephesos, kur thotë se “populli i mallkuar i Sllavëve e ka shkretuar të gjithë vendin në Heladë, në provincën e Thesalisë dhe në Traki, ku për katër vite kanë plaçkitur çdo gjë. Jetojnë pa u shqetësuar dhe frikësuar duke plaçkitur, vrarë dhe djegur, janë bërë të pasur dhe posedojnë ar dhe argjend, tufa kuajsh dhe shumë armë”.<sup>383</sup>

Në të vërtetë, bashkëveprimi i fiseve sllave me Avarët si dhe pjesëmarrja e tyre në fushatat e vazhdueshme kundër Perandorisë, veçmas në Ilirik dhe Dardani, që vazhduan për afër gjysmë shekulli, i shikuar nga këndvështrimi i historisë së Ilirikut dhe të Dardanisë në kuadër të Perandorisë së Bizantit, ka një domethënie të veçantë. Aty shfaqen ato rrethanat shoqërore dhe politike, që në një rën anë i paraprinë dobësimin të faktorit dardan-ilir si dhe etnisë së tyre brenda qyte-

---

<sup>380</sup>Shih Jireček, K. : “*Historia e serbëve*”, Tiranë 2010, faqe 112.

<sup>381</sup>Shih Ostrogorski, Georg “*Historia e Perandorisë bizantine*”, Tiranë 2002, faqe 61-63

<sup>382</sup>Rreth sjelljes së Sllavëve në pjesët e Ilirikut dhe të Thrakisë më gjerësisht shih: Jenkins, R.J.H “*Byzantium and Byzantinism*”; Johannes Biclariensis në Mon.Germ.,Auctores antiq.11,214-215; Johannes von Ephesos VI, “*Kleine Schriften*”, 25; Vasiljev A: “*Viz. Vrem.*” 5.

<sup>383</sup>Shih Michael, P: “*Chronique de Michelle Syrien*”, Paris 1905.

tërimit në kuadër të të cilit gjatë katër shekujve u deponua gjithë fuqia dhe dija që kishte për t'u kthyer në themel të saj.

Megjithatë, për qëndrim të përhershëm të Sllavëve në Ilirik, mund të bëhet fjalë vetëm nga shekulli VII-X, pasi që fillimisht të jenë vendosur nga perandori Herakli në disa pjesë të Trakisë dhe të Ilirisë. Prania e përhershme e fiseve sllave në Ilirik njihet nga ngulimet e tyre si “*slavinen*” (Σκλαβιναι) në greqisht dhe “*Sclavenia, Sclavonia*” e më rrallë “*Sclavinica*” në latinisht prej nga fillon edhe diferencimi nga ajo që sipas Nikephiris Bryennios quhej “populli i Sllavëve “ (Σκλαβινων εσως). Pastaj Michael Rhetor i Thessalonikut, rreth vitit 1072, quhen “*slavinën*”. Ndërsa, Niektas Akominatos (rreth vitit 1204), nga “populli i Sllavëve”, në hapësirën e perëndimore të Ilirikut, sheh kryesisht “*dalmatët*”.<sup>384</sup>

Nëse mund të pranohet edhe kushtimisht se bërthama e organizimit fisnor të sllavëve me zhupanët dhe feudalet e parë nga shekulli IX e këndeje kryesisht lidhet me Zaxhluminë, me Neretvën dhe Travurninë në Bosnjen Qëndrore,<sup>385</sup> shfaqja e dinastisë Nemanjide në Diokle (Zenta dhe Zeta) si dhe përhapja e saj në shekullin XI nga kjo pjesë në Rashës (Rasen antike), edhe fuqizimi i saj në dy shekujt e ardhshëm në drejtim të jug-lindjes, sjell paqartësi në procesin e diferencimit të mëtutjeshëm etnik, kur një pjesë e tyre shfaqen kroatë, sllovenë dhe serbë me të cilat lidhen edhe identitetet e caktuara shoqërore dhe politike brenda për brenda Perandorisë. Kjo vlen veçmas për dinastinë rasiane Nemanjide, nga shkaku se origjina e tyre, në përputhje me autorët bizantinë, lidhet kryesisht me Tribalët,<sup>386</sup> popull ky antik, i shtrirë në provincën e Myzisë midis lumenjve Moravë dhe Danub, po edhe në Panoni e në Travurni, ku u ruhen gjurmët,<sup>387</sup> të cilët një pjesë e madhe e historiografisë serbe me kokëfortësi

---

<sup>384</sup> Shih Jireček, K.: “*Historia e serbëve*” 2, Tiranë 2010. Faqe 100.

<sup>385</sup> Shih: Porphyrogentius, Constantinus: “*De Thematibus et de Administando Imperio*”, Bonnae MDCCXL; Orbin M: “*Il Regno degli Slavi hoggicarrottament detti sclavoni*”, 1601; Relja Novaković: “*Gde se nalazila Srbija od VII-XII veka*”; Stanojević, M: “*Byzant und die Serben*”, Beograd 1893; Manojlović, S: “*Das Adriatische Küstengebiet im 9 Jahrh.*”, Beograd 1902; Svejović, Dragan: “*Balkanski istočnjaci Milana Budimira*”, Beograd 2001.

<sup>386</sup> Shih: Chalconcandylae, Leonici: “*Historiarum Demonstrationes*”. Kronisti bizantin përemend Tribalët dhe Tribalinë në faqe: 14,19,20,23,27,30, 49,67,75, 146, 161, 176, 177 dhe 278; Cristobulos: “*Imbriotae Historiae*”, ed. D.R. Reinsch, Berlin, New York 1983, faqe 27,85,94,96,98); Dölger, F- Karayannopoulos, J: “*Byzantinische Urkundenlehre*”, München, 1965. Johannes Biclariensis në Mon.Germ., Auctores antiq. 11,214-215; Johannes von Ephesos VI, “*Kleine Schriften*”, 25; Vasiljev A: “*Viz. Vrem.*” 5.

<sup>387</sup> Burime të ndryshme antike, nga ato që jep Herodoti te “*Historiae*” dhe Arrius, Flavius Lucius në veprën “*Aleksandria Anabasis*” dhe “*Scripta minora et fragmente*”, shtrirjen e Tribalëve, krahas rrjedhës së lumit Morava deri te Danubi në pjesën dhe në anën e sipërme në lindje, e paraqesin edhe në pjesën e Panonisë, rrjedhës së Savës e deri në Neretvë. *Travunija* është quajtur *Trivalija*. Emërtimi *Tribal* ruhet në shumë toponime dhe hidronime të Bosnjës dhe Posavinës. Kështu, *Tribal*, quhet një kodër në rrethinën e Cërkve-

vazhdon konvertimin e Tribalëve në serb,<sup>388</sup> paçka se ata nuk kanë kurrfarë lidhjesh gjenetike me serbët e as ndonjë pikë tjetër afrie pos hapësirën e njëjtë gjeografike,<sup>389</sup> ndërsa nga autorët e vjetër dhe bizantinë shihen si “degë ilire”,<sup>390</sup> prania e të cilëve është fare e natyrshme, sidomos në aspektin etnik, edhe në zhvillimet e mëtejshme, përkundër humbjes së rolit që kishin në antikitet, kur për herë të fundit përmenden pas humbjes nga Filipi i Maqedonisë, gjatë fushatës së tij në Ilirik dhe Thaki në vitin 344/3.<sup>391</sup>

Por, si do të shihet, konvertimi i Tribalëve në serbë në formën më antishkencore, gjithsesi se ka të bëjë me dilemat e shumta rreth “shtetit” mesjetar serb dhe Serbisë së sajuar Mesjetare, që si të tilla nuk i përjashton edhe ndonjë autor kritik serb,<sup>392</sup> sqarimi i të cilave nxjerr një pamje tjetër edhe të vetë krijimit

---

nicës, *Tribion* – një katund afër Benkovcit, *Tribija* – në afërsi të Visokos në Bosnje, *Tribinal* – mal afër Mostarit etj. (Shih: Живојин, Андрејић: “*Бладару Трибала*” (*Vladari Tribala*), 1979 dhe „*Rača i okolina*“) Ky autor amdje, ndër të vetmit deri më tani, sheh edhe lidhje gjenetike midis Tribalëve dhe Nemanjajve. Me Tribalët si realitet historik i dhe etnik i pakapërcyeshëm në hapësirën e Serbisë së sotme dhe një pjese të madhe të Gadishullit nga antikiteti e deri në mesjetë, merret edhe Milorad Stojić. Në librin “*Трибалу у археологију и историским изворима*” (*Tribali u arheologiji i istoriskim izvorima*), 2017, jep një pamje komplekse të këtij populli të fuqishëm antik dhe qytetërimin të tij të zhvilluar, gjurmë të cilit gjenden edhe në Serbinë e sotme, ndonës shumë prej tyre janë trajtuar njëanshëm “si trakase” ose dake.

<sup>388</sup> Me konvertimin e Tribalëve në Serbë, krahas Qirkoviqit, Novakoviqit dhe autorëve të tjerë, kohëve të fundit, me të mardhe merret historianja M. Nikolić, e cila thotë se “autorët antikë kur flasin për Tribalët kanë pasur parasysh Serbët!” (Shih: Nikolić Maja: “*The Byzantine Writers on Serbia*”, Beograd, 2010, faqe 41-69). Kjo pikëpamje joshkencore gjithësesi se gjen mbështetje te volumi 6 i Enciklopedisë së Jugosllavisë, „*Vizantinski izvori za istoriju Jugoslavie*”, Beograd, 1986, ku të dhënat e autorëve bizantinë rreth Tribalëve të Halkonkandik, Kristobulusit, Dukas dhe të tjerëve, vazhdimisht shoqërohen me „sqarimin“ se „Tribalët - nënkuptohen Serbët!“! Metoda brutale e konvertimit të popujve bizantinë në serbë vazhdon edhe me Keltët, të cilët, në Enciklopedinë Jugollave, kudo, në paranteza, paraqiten serb!

<sup>389</sup> Shih: Стојић, Милорад: „*Трибали у археологију и историјским изворима*“, Београд, 2017, faqe 36,68, me ç'rast thotë se populli më i vjetër i Serbisë së sotme, edhe pse nuk ka kurrëfarë faktesh se kanë pasur ndonjë lidhje historike ose pikëpjekje me serbët, kanë zotëruar udhëkryqet kryesore, që kanë lidhur Perëndimin me Lindjen. Ky popull ka pasur një qytetërim të lartë dhe shtet të fortë, që i dha fund Filipi i Maqedonisë në vitin 343 para erës sonë.

<sup>390</sup> Kronisti bizantin Halkonkandili thotë te Tribalët janë “degë ilire”. I vlerëson “popull më i vjetër dhe më i fortë i botës”. Thotë se “Tribalët dhe Mizët dhe Ilirët flasin të njëjtën gjuhë” (“*Historiarum Demonstrationes*” I, faq 23-24,30). Kronisti bizantin, me këtë rast Tribalët dhe Tribalinë i paraqet të përfshirë në fushatën e Mehmetit në këtë pjesë, thotë se “Mehmeti u sul kundër vendeve të Tribalëve më 1439 dhe me këtë rast, mori për grua të bijën e princit të Tribalëve, Marën” (“*Historiarum Demonstrationes*”, II faqe 280-289). Edhe Critobulos flet për “*Tribalët dhe vendet Tribale*”, në Trakinë Veriore, duke filluar nga Myzija e Epërme dhe malet Hem e deri te Istria, që ndan ata me vendet e Dakëve dhe të Pajonëve. Ndërsa, kur flet për pushtimet e Mehmet Pushtuesit, thotë se ai “*sulltani sulmoi Tribalinë më 1455, sepse nga Tribalialia më lehtë sulmonte Peoninë dhe Dakët*”. Cristobulos, po ashtu, flet edhe për pasuritë e shumta natyrore të tokës Tribale me ari, argjent dhe të tjera si dhe lavdëron popullatën “e re dhe të bukur tribale” (“*Imbriotaе Historiae*”, Berlin-New York, 1983, faqe, 94, 96 dhe 156). Ndërsa N. Grigor Dushanin e quan: “*mbreti tribal*” (“*Byzantinina Historia*”, ed.Bekkerus, Bonnae, 1855). Edhe Simeoni, peshkop i Selanikut, thotë se “Mehmeti I, në Ohër luftoi kundër Tribalëve” (Beifur: “*Simeon of Thessakonica*”, faqe 50, 51 dhe 131,132.)

<sup>391</sup>Halkokondili: “*Historiarum Demonstrationes*” I, faq 23-24,30).

<sup>392</sup> Новаковић, Рела: „*Где се налази Србија од VI-XII до века*“, Београд, 1981.

të shtetit serb në shekullin XIX jashtë amëzës historike dhe jashtë hapësirës etnike.

## MAQEDONIA DHE DARDANIA GJATË PUSHTIMEVE BULLGARE

Krahas depërtimeve (pushtimeve) të njohura të fiseve barbare sllave nga veriu, të cilat derdeshin nga pjesa e Karpateve dhe të shumtën me Avarët, Hunët dhe të tjerët kalonin Danubin, prej nga në kohën e perandorit Herakli, si “mburojë kundër barbarëve”, një pjesë e tyre e mirë mbeteshin përgjithmonë në Traki dhe në Ilirik, megjithatë rreth fundit të shekullit VII, një tjetër popull barbar kaloi Danubin dhe u hodh drejt Ilirikut me qëllim plaçkitjeje. Ky popull quhej Bullgar dhe lidhej me Hunët dhe Avarët e tmerrshëm.

Bëhet e ditur se grupi i parë i Bullgarëve që kaloi Danubin në vitin 679, arriti të pushtonte territoret ndërmjet Danubit dhe maleve Ilirik. Fillimisht Perandoria Bizantine nuk bëri gjë që këtë ta parandalonte, meqë ishte e përfshirë në luftë me Arabët. Por, pas pak, pasi që me Arabët kishte arritur të nënshkruante një marrëveshje paqeje, perandori Konstantin IV e kuptoi rrezikun e ri, që po i vinte nga veriu dhe filloi punën për t’u marrë me Bullgarët para se ata të kalonin Danubin. Në të vërtetë Mbretëria Bullgare apo Anoguro-Bullgare, me të cilën Perandoria Bizantine kishte vendosur marrëdhënie miqësore në kohën e Heraklit, ishte vënë në lëvizje drejt Perëndimit nga trysnia e Hazarëve, një populli, i cili po ashtu po bëhej gjithnjë e më dominues në pjesën qendrore midis Karpateve dhe Ukrainës. Kështu, një grup i madh i Bullgarëve, nën drejtimin e Asparukut, lëvizi drejt Perëndimit dhe në vitet e shtatëdhjeta u shfaq në deltën e Danubit. Perandori Konstantin IV doli t’i priste Bullgarët këndeje Danubit që në atë pjesë t’ua ndalte rrugën, por atje ushtria i mbeti ngujuar në pjesët moçalike, prej nga u bë pre e sulmeve bullgare ku edhe u thye. Kështu, ekspedita e dështuar e Kostandinit IV e papërgatitur si duhej për një luftë me një kundërshtar që edhe më këndeje luftonte me logjikën e plaçkitjeve të shpejta dhe lëvizjeve të paparashikueshme, nuk bëri gjë tjetër veçse u hapi rrugën Bullgarëve të bënin hapin e fundit, me ç’rast ata kaluan Danubin dhe pushtuan Varnën.<sup>393</sup>

Në këto rrethana u themelua shteti bullgar, me qendër në rajonin jugor të Danubit (të quajtur Moesia në periudhën romake) dhe filloi të zgjerohej në drejtim të Jugut dhe Perëndimit për aq sa u lejohej hapësira. Por, fuqia më e madhe e

---

<sup>393</sup> Rreth rolit të bullgarëve si elitë ushtarake dhe politike si dhe sllavëve në shërbim të tyre shih: Ъиречек, Константин: *"Истрия на Българи"*, София 1928; Мутапчиев, П.: *"История на българиите"*, София, 1934.



Bullgarëve u shtua pasi që ata të kenë filluar të përzihen me popullatën sllave. Fjala është për përzierjen tërësore të popullsisë bullgare me atë sllave, midis një populli indoeuropian (Sllavët) dhe një tjetri joindoeuropian, ose midis racës së bardhë dhe asaj të verdhë tatare-mongole. Kjo e dyta, shfaqej në rolin e elitës ushtarake dhe politike, ndërsa sllavët, si masë, – në shërbim të tyre.<sup>394</sup>

Megjithatë, nuk mund të thuhet se shteti bullgar me origjinë aziatike u shndërrua në një shtet sllav prej nga pastaj dalin edhe vlerësimet e njëanshme se fjala është “për shtetin e parë sllav të mirëfilltë në Ilirik”.<sup>395</sup>

Në të vërtetë, shteti autonom bullgar në Ilirik, ishte fenomen i një përzierjeje racash të ndryshme euro-aziate, por atë e bashkoi faktori gjuhë (një përzierja bull-gare-dake-sllave) si dhe krishterimi, nga shekulli IX dhe X. Kështu, nga fillimet e pranimit të krishterimit, Bullgaria kërkoi të forcohej dhe madje të sigurote pozitë ndërlidhëse midis Romës dhe Kostandinopojës, pikërisht çfarë e kishte Iliriku midis pjesës lindore dhe perëndimore nga koha e Dioklecianit e deri te ajo e Justi-nianit, kur aty ruheshin po edhe sprovoheshin baraspeshimet e Perandorisë. Bo-risi, i cili u njoh si mbret nga Bizanti, pasi që pranoi krishterimin dhe Bullgaria u kthye në shtet të krishterë, me një kishë pjesërisht të pavarur nga Patrikana e Kostandinopojës. Ishte ky një fenomen i ri, që Bizantit i duhej, veçmas kur dihej se Borisi, krahas Kishës Lindore kishte vënë lidhje paralele edhe me Kishën e Romës. Për të penguar ndonjë lidhje me të fortë me Romën, kisha e Kostandinopojës u lejoi atyre kishën e tyre, të organizuar me kryepeshkopë dhe peshkopë.

Edhe përkundër kësaj, Borisi disa herë u përpoq që për përfitime të dyfishta, të fuste kishën perëndimore në lojë për ta fituar një status të veçantë edhe në Perëndim. Kur kësaj nuk ia doli, atëherë iu kthye i tëri ndikimit grek dhe dërgoi të birin Simeonin në Kostandinopojë të pajisej me edukimin grek. Simeoni zëvendësoi të atin, pasi që ai të jetë tërhequr në një manastir, ku pas pak vdes. Natyrisht, se Simeoni (897-923) ia doli që të forcojë Mbretërinë Bullgare në Ilirik dhe ta pavarësojë atë nga Bizanti, me ç’rast futi në lojë edhe Selinë e Shenjtë. Ai, po ashtu, krijoi edhe identitetin shtetëror dhe kulturor bullgar, me anën e kishës bullgare.

---

<sup>394</sup> Më gjerësisht rreth “karakterit sllav” të shtetit bullgar shih te shih Ostrogorski, Georg: “*Historia e Perandorisë Bizantine*”, Tiranë 2002, faqe 83.

<sup>395</sup> Shih: Мутапчиев, П.: “*История на българите*”, София, 1934; Златарски, В.: “*Българска Ивстация в хрониката на Симеон Метафраста и Логотет*”, София 1908; Schevill, Ferdinand: “*Iliriku – historia dhe qytetërimi*”, Tiranë, 2002, faqe 91.

Si e tillë Mbretëria Bullgare arriti në pjesën e Ilirikut, duke shtrirë pushtimet e veta nëpër Dardani dhe Maqedoni, të cilat si dihet administroheshin nga Lindja, por ndodheshin nën juridiksionin e Selisë së Shenjtë. Ndonëse kjo gjendje tashmë kishte marrë fund me Koncilin VIII të Kostandinopojës të vitit 870, kur viset e pushtuara Ilirikut i kalonin juridiksionit të Patrikanës së Kostandinopojës, megjithatë Bullgarët kishin treguar gatishmëri që ta ruanin përkatësinë perëndimore të kishës dardane, po qe se këtë do ta kthenin në leverdi në marrëdhëniet e tyre me Selinë e Shenjtë, që dëshironin t'i ruanin si të veçanta. Janë të njohura disa nga lidhjet e Borisit me përfaqësuesit e Selisë së Shenjtë, të cilat kishin për qëllim përfitime sa më të mëdha. Kur e pa se në këto lojëra midis kishës lindore dhe asaj perëndimore më e rëndësishme ishte lidhja me Kostandinopojën ku edhe mund të siguronte njëherësh fuqi politike dhe kishtare, mbreti Boris i ndodhur përballë një trysnie të madhe ushtarake të Bizantit, përfundimisht do t'i kthehet kishës lindore, prej nga ai ia doli që qendrën e shtetit bashkë me atë të kishës ta zhvendoset në Ilirik, pra në Ohër, ku kishte qenë edhe qendra kishtare e Selisë së Shenjtë gjatë tre shekujve të fundit e lidhur me Dardani dhe cila, nga pikëpamja administrative dhe kishtare, nga reformat e Dioklecianit e këndej, kishte përthithur në tërësi pjesën e Maqedonisë antike. Kështu, ajo që për Selinë e Shenjtë ishte dikur Jusitiana Prima, për Bullgarët do të bëhet peshkopata e Ohrit.

Para se të ndodhë kjo, mbretit Boris (852-879) i duhej që të shtrinte pushtetin e vet në këto anë. Kjo ndodhi me përfshirjen në pushtimet e veta edhe të brezit midis lumit Devoll dhe Vjosë. Kështu që kështjella e Devollit dhe e Puleropolit (Berati) u bënë baza të pushtetit bullgar në brezin bregdetar të Ilirikut.<sup>396</sup>

Rrugën e Borisit ndoqi edhe i biri, Simeoni. Ai iu kthye pushtimeve të mëtuqeshme. Kështu, në kohën e Simeonit Bullgaria arriti shtrirjen e saj më të gjerë në Ilirik (në Dardani dhe Maqedoni). Me përjashtim të Durrësit dhe Shkodrës, Simeoni pushtoi krejt viset në Ilirikun jugor. Në jug mori Vlorën dhe një pjesë të mirë të Temës së Nikopojës.

Në këtë përpjekje Simeoni prapë iu kthye Selisë së Shenjtë, i bindur se me anën e saj do të fitonte një pozitë edhe më të fuqishme. Në vitin 891 vuri lidhje

---

<sup>396</sup> Shih: Jiriček, Konstadin: "*Historia e Serbëve*", Tiranë, 2010, faqe 256; "*Historia e Popullit Shqiptar*", Tiranë, 2002, faqe 218; Runciman, S: "*A History of the First Bulgarian Empire*", London 1930; Златарски, В: "*Историята на България състоянието на Средновековието*" I, София, 1918.(Zlatarski, V: "*Istoriyata na Bŭlgariya sŭstoyaniето na Srednovekoviето*" I, Sofiya, 1918.)

me Formozën, prej të cilit kërkoi kurorë mbretërore (Bullgarët e quajnë perandorake), të cilën Selia e Shenjtë ia ndau me të shpejtë.<sup>397</sup>

Marrja e përkrahjes nga ana e Selisë së Shenjtë si dhe forcimi i pozitave në pjesët e tjera të Perandorisë, ku e kishte shtrirë pushtetin, Simeoni kërkonte që pushtetin e tij ta kurorëzonte me marrjen e Kostandinopojës, sepse atij nuk i mjaftonte haraçi i paqes që Perandoria e Bizantit ia paguante çdo vit në përputhje me traktatin e paqes të vitit 896. Shkas për këtë veprim gjithsesi se bëhet qeverisja e dobët e saj, kur në krye të Perandorisë, pas vdekjes së Leonit VI në vitin 912, erdhi Aleksandri mendjelehtë, i cili refuzoi të paguante haraçin, gjë që Simeoni e pa të udhës se ishte koha t'i vërsulej kryeqytetit bizantin. Fati i luftës i buzëqeshi bullgarit pasi që vdiq Aleksandri, ndërsa vendin e tij, si regjent i të birit gjashtëvjeçar, e mori patriku Nikolla Mistiku, i cili ia doli që mangësinë e kompetencës ushtarake ta shfrytëzojë me atë të fuqisë diplomatike, duke e joshur Simeonin në bisedime, me anën e të cilave atij do t'i lejohej hyrja në Kostandinopojë, ku edhe do të kurorëzohet bashkëperandor dhe këtë kurorë do ta marrë nga duart e patrikut.<sup>398</sup>

Kënaqësia e Simeonit që pa luftë të bëhej bashkëperandor, nuk zgjati shumë. Pas kthimit në Bullgari dhe lëshimeve të mëdha që i ishin bërë, në kryeqytet shpërthyen trazira të mëdha, të cilat sollën rrënimin e patrikut Nikollë, i cili u përmbys nga nëna perandoreshë Zoe, e cila i shpalli të pavlefshme marrëveshjet me Simeonin.<sup>399</sup>

Gjendja e re prapë i dha shkas Simeonit që të fillojë një fushatë të madhe kundër Bizantit me pretendimin që përfundimisht t'ia rrëmbejë kurorën perandorake. Sërish ndërmori një fushatë ushtarake, e cila suksesin më të madh e arriti me thyerjen e flotës ushtarake perandorake në Detin e Zi, prej nga ai prapë doli te muret e Kostandinopojës, që nuk ia doli t'i kapërcejë, edhe pse këtë herë si aleatë pati edhe Arabët. Në pamundësi të suksesit ushtarak, Simenoni, në vitin 924 pranoi bisedimet me Romanin I, i cili prapë ia ofroi kurorën perandorake, të vlefshme vetëm për hapësirën bullgare. Kjo bëri që ai t'u hakmerrej disa aleatëve të fshehur të Bizantit nga radhët e zhupanëve Sllavë, veçmas atij të Zaxhlumisë, i cili luante lojën e dyfishtë me të dy kishat. Me ambiciet që të shtrinte pushtetin deri aty ku Bizanti përkufizohej me Perandorinë Perëndimore, pra këndej Ilirikut Perëndimor, Simeoni u përball me Tomisllavin e Kroacisë, me ç'rast ushtria e tij

---

<sup>397</sup> Shih Forverial, Zhan Klod: "Historia e Shqipërisë", Tiranë 2004, faqe 140; Runciman, S: "A History of the First Bulgarian Empire", London 1930.

<sup>398</sup> Shih Ostrogorski, Georg: "Historia e Perandorisë Bizantine", Tiranë 2002, faqe 176; Litavrin: "Bolgarrija i Vizantija v XI-XIII vv", Moskva 1960; Herrin, Judith: "Byzantium", Munchen, 2008.

<sup>399</sup> Po aty.

pësoi një humbje të papritur, por të thellë, shkaqet e njëmendta të së cilës asnjëherë nuk u morën vesh kur dihej se çfarë ishte në të vërtetë raporti i forcave midis palëve luftarake. Sidoqoftë, Simeoni në vitin 924, u detyrua të nënshkruante paqe me Kroatët, me shpresë që këtë humbje ta zhdëmtonte së shpejti me një fushatë tjetër kundër Kostandinopojës, që mbet vetëm dëshirë, ngaqë pas pak vdiq.<sup>400</sup>

Me vdekjen e Simeonit filloi shthurja e shpejtë e asaj që shfaqej si mbretëria utonome bullgare nën kurorën e Bizantit. Por, si u pa edhe më herët, pushtimi bullgar në Ilirik (në Dardani dhe në një pjesë të mirë të Maqedonisë), ndikoi në shtrirjen e një kulture bullgare-bizantine, e cila kryekreje shkonte në dëm të asaj katolike-perëndimore, së cilës i kishte takuar kisha e saj nga koha e Konstantinit të Madh dhe veçmas nga koha e Justinianit, i cili peshkopatën e Ilirikut në Justiniana Prima, si vikariat, e kishte lidhur me Selinë e Shenjtë dhe si e tillë do të mbetet për më shumë se tre shekuj.

Nxitësit e saj kryesorë, vëllezërit Qirili dhe Metodi si dhe misionari Klement i Ohrit, të cilët në pjesën e Ohrit, Korçës, Devollit, Beratit, por edhe këndeje tyre në drejtim të Maqedonisë dhe të Dardanisë, punuan për vite me radhë për hapjen e shkollave dhe kishave bullgare. Kjo veprimtari u mundësua pasi që Bullgaria Ohrin e kthen në qendër të patriarkatit të pavarur bullgar.<sup>401</sup>

Por, ajo që mund të quhet kulturë bullgare-bizantine në Ilirik, ka të bëjë me përhapjen e krishterimit te popujt sllavë që kaloi nëpër një garë të brendshme midis patrikanës së Kostandinopojës dhe Selisë së Shenjtë për përhapjen sa më të plotë të ndikimit të ta, pasi që ishin përhapur nga Iliriku deri në Moravi dhe Çeki dhe ndodheshin në një gjendje kur kalonin nga paganizmi në monoteizëm. Në këtë punë misionare do të përfshihet kisha greke e cila pranoi thirrjen e princit të Moravisë, Rastislaos, i cili kërkonte nga Kostandinopoja misionarë të krishterë që do t'i ndihmonin përhapjes së krishterimit në këto anë me anën e një liturgjie të kuptueshme për ta.

Arsyet pse princi i Moravisë kërkonte misionarë bizantinë kishin të bënin me ato politike, meqë ai kërkonte një kundërpeshë nga rreziku i rrethimit franko-bullgar. Fakti që udhëheqja politike e kishtare bizantine ua besoi misionin e rëndësishëm vëllezërve nga Selaniku Konstadinit (Qirilit) dhe Metodit dhe që në viset sllave e predikoi fenë e re në një gjuhë sllave, është tregues i largpamësisë së saj, që të veprohet në përhapjen e krishterimi në botën e madhe sllave jashtë kufijve të

---

<sup>400</sup> Shih: Sisič, P: "Geschichte der Kroaten" I, Zagreb 1917; Dögler: „Bulgarisches Zartum und byzantinisches Keisertum“, në Bull. De L'Institut archelog. Bulgare 9/1935

<sup>401</sup> Po aty, faqe 218.

Perandorisë në një mënyrë më joshëse për popujt barbarë, të cilët nuk ishin në gjendje që kapërcimin nga njëra gjendje shpirtërore në tjetrën ta bënin në gjuhën latine, por në atë amtare dhe pa ndonjë rregull fanatik siç kërkonte riti katolik.<sup>402</sup>

Kisha lindore në këtë drejtim ishte shumë më praktike, krahasuar me atë të Romës, që latinishten e kishte kod kryesor liturgjie dhe shkrimi. Në përputhje me këtë qëndrim, që ishte më shumë politik se fetar, por gjithsesi emancipues, Konstantini (Qirili) krijoi një alfabet sllav, alfabeti i ashtuquajtur glagolik dhe iu fut pastaj përkthimit të Shkrimit të Shenjtë në sllavisht (në dialektin sllavo-bullgar).<sup>403</sup>

Misioni i Qirilit dhe Metodit si dhe veprimtaria e tyre në të mirë të përhapjes së liturgjisë në sllavishte në pjesët ku mbizotëruese ishte ajo greke, pasi që ata të jenë dëbuar nga Moravia pikërisht se gjuha e liturgjisë së tyre shfaqej si pjesë e herezisë, ngaqë përjashtonte latinishten si kod universal, preku edhe Ilirikun. Misionarizmi i Qirilit dhe Metodit në të mirë të një liturgjie të sajuar të quajtur gjuhë e vjetër kishtare, (një përzierje gjuhësore bullgaro-sllave ende e padefinuar mirë)përkoi me sulmet bullgare në Ilirikun jugor. Me këtë rast Borisi i Bullgarisë, pasi që iu kthye sërish ortodoksisë, prej nga ia doli që nga Patrikana e Kostandinopojës të sigurojë kishën e pavarur, në vitin 870 themeloi kryepeshkopatën bullgare në Ohër, ku do të shihen të veprojnë edhe vëllezërit Qirili dhe Metodi, të cilët qendrën e kishin në manastirin e Kutmiçevicës.<sup>404</sup>

Veprimtaria e Qirilit dhe Metodit dhe në vazhdim ajo e Klementit dhe Naumit,<sup>405</sup> ndonëse kishtare, nuk mbeti pa u përfshirë në përvijimet por edhe garën e njohur të kishës lindore ndaj asaj perëndimore. Kështu, fillimisht e nxitur nga kisha bizantine, për ta penguar ndikimin franko-bullgar në Ilirik, ku po zhvillohej fushata për krishterimin e Sllavëve, në këtë do të kyçen Bullgarët, të cilët tashmë ndodheshin në dinamikën e pushtimeve drejt pjesëve perëndimore të Perandorisë, pushtime këto që shiheshin me sy të mirë nga Selia e Shenjtë, e cila faktorin bullgar mendohej ta kthente për vete në mënyrë që ta dobësonte Kostandinopojën.

---

<sup>402</sup> Kulakovski, J. "Istoria Vizantii", Kijev, 1915, faqe 161.

<sup>403</sup> Shih: "Групо у Методује", Српска Књижевна Задруга, Београд, 1964 dhe Splawinski, T: "Zywoty Konstantyna i Metodego", Poznan, 1959.

<sup>404</sup> Shih: Dvornik, F: "Les Slaves, Byzance et Rome au IX siecle", Paris 1926; Jacques, Edwin: "Shqiptarët", Tiranë, 179.

<sup>405</sup> Naumi i Ohrit (Shën Naumi) ishte nxënës i Qirilit dhe Metodit, që u përfshi në përhapjen e alfabetit të vjetër kishtar të quajtur sllaven që u përdor në liturgjinë kishtare paralelisht me atë grek. Në këtë mision iu bashkua edhe Klimenti. Pas telasheve që patën me misionarët katolikë, Mbreti Boris i mori në mbrojtje dhe u krijoi kushte për të krijuar "Shkollën e Ohrit". Naumi vdiq në vitin 910 dhe u varros në manastirin e Ohrit, që e kishte themeluar në vitin 895. Kisha bullgare e ka shpallur të shenjtë Naumin. ("Групо у Методује", житија, службе, канони, похвале", приредио Ђорђе Трифунович, Београд 1964).

Në të vërtetë, kjo edhe do të ndodhë pas themelimit të kryepeshkopatës bullgare në Ohër, ngaqë Simeoni atë e ktheu në një qendër shpirtërore por edhe politike prej nga ai, me përkrahjen e Selisë së Shenjtë dhe bekimin që mori prej saj, ia doli të largojë, po edhe të përjashtojë ndikimin e kishës lindore me largimin e peshkopëve Grekë dhe emërimin e atyre që vinin nga mendësia e Klementit dhe Naumit, veçmas këtij të dytit, i cili në një kodrinë në jug të liqenit të Ohrit, në rrënojat e një bazilike të hershme, ngrit një manastir, ku edhe do të vendoset përfundimisht.<sup>406</sup>

Edhe përkundër misionarizmit të Qirilit dhe të Metodit si dhe nxënësve të tyre Klementit dhe Naumit, që pak a shumë, është i dëshmuar ashtu si njihet, meqë ata kanë lënë pas edhe gjurmë kulture me të cilat janë lidhur Sllavët e Jugut dhe ata të Perëndimit, historia e kapërcimit nga njëri rit i krishterë te tjetrit nga Sllavët përcillet me shumë e shumë prapaskena disa prej tyre edhe dihen. Veçmas ato që kanë të bëjnë me garën e madhe të kishës greke dhe të asaj latine, që ishin pranë Sllavëve, të cilat mundoheshin t'i kalonin besimtarët e rinj nën ndikimin e tyre. Kështu, shumë princa dhe kryetarë sllavë e pranuan fenë e re, jo nga premtimet hyjnore që ajo sillte, as pse ndryshuan shpirtërisht prej tyre, por nga kushte të përshtatshme politike dhe përfitime të mira që sillte pranimi i fesë së re me ç'rast ata faktorizoheshin politikisht.

Megjithatë, siç u pa, përhapja e krishterimit ndër Sllavë, pati si shtysë thujse kryesore - elementin bullgar, i cili për pak kohë ia doli që nga populli barbar që depërtonte nga veriu, pasi që do të pranojë krishterimin, qoftë edhe sa për sy e faqe, siç ishte në fillim, u kthye në një faktor tejet të rëndësishëm shoqëror dhe politik me të cilin do të lidhet fati i Bizantit deri aty që në kohën e Samuilut perandoria t'u paguante edhe haraç madje.<sup>407</sup>

Por, ardhja dhe vendosja e tyre në Ilirik, po ashtu, ndikoi që Iliriku dhe pjesa e rrudhur e Arbërve të përfshiheshin në një zhvillim shoqëror dhe politik i cili karakterizohej nga një luftë e ashpër për pushtet midis Bullgarëve, që kërkonin të zgjeroheshin dhe të dominonin në Ilirik dhe Bizantit, që bënte përpjekje të ruhej, por edhe të transformohej edhe më tutje identiteti administrativ dhe shoqëror brenda realiteteve politike të një bote sllavo-ortodokse, që tashmë e tëra mbikëqyrej nga kisha e Kostandinopojës, e cila bënte çmos që ta kthente gjithnjë e më shumë kah Lindja dhe kundër Perëndimit. Si do të shihet, në këtë zhvillim, do të jenë

---

<sup>406</sup> Shih: Faverial, Zhan Klod: "*Historia e Shqipërisë*", Tiranë 2004, faqe 141; Gjini, Gaspër: "*Skopsko-prizrenska biskupija kroz stoljeća*", Zagreb 1986, faqe 77.

<sup>407</sup> Йиречек, Константин: "*Истрия на Българи*", София 1928; Мутапчиев, П: "*История на българите*", София, 1934.

pikërisht strukturat administrative të Bizantit, *thema*, si formë organizative, që kishte zënë fill nga koha e perandorit Herakli e këndej, (me anën e së cilës, pushteti i dikurshëm i principatave i kohës së Justinianit ishte zëvendësuar me atë të qeverisjes administrative-ushtarake, që mbikëqyreshin nga qendra dhe kishin për qëllim që ato të mbikëqyreshin në mënyrë të rreptë), ato që do të paralajmërojnë rikthimin e pushtetit vendor dhe përdorimin e tij për nxjerrjen e strukturave udhëheqëse autonome (nga zhupanitë e deri te despotatet e pavarura), që sapo të shfaqen, do të sjellin dobësimin, shthurjen dhe rënien e Bizantit.

Kur jemi te çështja shpirtërore dhe ato që lëvizi shfaqja e sundimit bullgar në Ilirik (në provincën e Maqedonisë, e cila nga pikëpamja administrative dhe ajo shpirtërore po shkrihej në etninë dardane), duhet thënë se përfshirja e plotë e dioqezave kishtarë të Ilirikut, të cilat deri më atëherë ishin nën juridiksionin e Selisë së Shenjtë, nën juridiksionin e kishës së Kostandinopojës, që ishte bërë me vendimin e Koncilit të tetë të vitit 830, solli edhe shfaqjen e sektit të bogomilëve, armik i egër i kishës.<sup>408</sup>

Doktrina e themeluesit, popit Bogomil, merrte shkas nga doktrina e mesalianëve e veçanërisht e pavlikanëve, të cilët, pasi u shpërngulën në mënyrë masive në Traki nga qeveria e Bizantit, jetonin në kontakt të ngushtë me popullsinë sllave të Bullgarisë. Përhapja e mëtejshme e Perandorisë bullgare në Ilirik, veçmas në drejtim të Perëndimit, bogumilizmit i dha mundësi që të përhapet edhe në këto pjesë. Kështu, ata në hapësirën e Bosnjës së sotme, krijuan një qendër të fuqishme prej nga mësimet e saj shqepeshin në drejtim të Perëndimit dhe Jugut.

Qendra bogumile u ruajt deri në kohën e ardhjes së Osmanëve në këto pjesë me ç'rast shumë nga besimtarët e këtij sektit, që të mos binin nën shtypjen e dogmës së krishterë, nga e cila ishin larguar prej kohësh, pranuan islamin, duke iu bashkuar shiitëve, si një besim që atyre u afronte mundësi që të ruanin filozofinë e dualizmin shpirtëror që mund të lidhej me anën e misticizmit lindor

---

<sup>408</sup>*Bogumilizmi* përfaqësonte një doktrinë dualiste, sipas së cilës bota drejtohej nga dy parime: *e Mira* (Zoti) dhe *e Keqja* (Satana) dhe lufta midis këtyre dy fuqive të kundërta përcakton gjithë ngjarjet e botës dhe çdo jetë njerëzore. Gjithë bota e dukshme është vepër e Satanit, pra prirret nga e Keqja. Ashtu si pararendësit e tyre të Orientit, bogumilët propagandonin një jetë fetare kryekëput shpirtërore dhe një mënyrë jetese rreptësisht asketike. Ata hidhnin poshtë me vendosmëri çdo kult të jashtëm, çdo rit kishtar dhe gjithë organizmin kishtar. Kryengritja bogumile kundër kishës zyrtare ishte në të njëjtën kohë një kryengritje kundër vetë rendit shekullor ekzistues, që kishte gjetur tek kisha mbështetjen më të fuqishme shpirtërore. Lëvizja e bogomilëve ishte shprehje e protestës kundër qeveritarëve, të fuqishmëve dhe të pasurve. Bogumilizmi hodhi rrënjë të thella në Bullgari e sidomos në Maqedoni. Pati ndikim të madh edhe shumë larg kufijve të Perandorisë bullgare dhe u shfaq nën emërtime të ndryshme edhe në Bizant, në Bosnje, në Itali e në pjesën jugore të mbretërisë franke.

dhe filozofisë perëndimore, e cila ruante konceptet e luftës së të mirës dhe të keqes.<sup>409</sup>

Pavarësisht sektit të bogumilëve dhe ndikimit të tyre, pas një kohe të nënshtrimit ndaj Perandorisë Bizantine, kur në fronin bullgar erdhi mbreti Samuil (976-1014), nën sundimin e tij, qendra e shtetit bullgar, u zhvendos nga Lindja, në Preslavi, në Prespë e Ohër ku kishte edhe peshkopatën e vet. Ishte hera e parë që trevat e Ilirikut, në kuadër të *themave* bizantine: Durrësit dhe Nikopojës, të përfshiheshin në konfliktin e gjatë bullgar-bizantin me pasoja të rënda për vendin, meqë ato ktheheshin në log luftërash, që prapa linin shkatërrime të mëdha, e mbi të gjitha pasiguri shoqërore dhe politike.

Në këto rrethana, kur Samueli kishte përfshirë në mbretërinë e tij pjesët nga provinca e Maqedonisë deri në Selanik dhe kishte bashkuar trevën e vjetër bullgare midis Danubit dhe vargmaleve Ilirike, e ku gjendeshin edhe Thesalia, *thema* e Nikopojës dhe Durrësit, bashkë me Dioklenë dhe Rashën në veri, Iliro-Dardanët dhe një pjesë e mirë e hapësirës së tyre, që më vonë do të njihet me emrin Arbëri, do të kthehet në një faktor tejet të rëndësishëm të Mbretërisë. Kjo ishte edhe e arsyeshme, meqë ata edhe më tutje, si etni e cila ndonëse kishte pësuar shumë pas dyndjeve sllave - duke u rrudhur nga veriu në jug, ndërkohë që Iliriku perëndimor që nuk ishte përfshirë nga zotimet italike dhe gjermane – brenda për brenda Themave (asaj të Durrësit e të Nikopojës), kishin ruajtur subjektivitetin e vet administrativ dhe shoqëror.<sup>410</sup>

I vetëdijshëm për rëndësinë e këtij faktori themelues të Bizantit, ku edhe më tutje ruhej nyja e kapërcimeve midis Lindjes dhe Perëndimit, Samueli nuk kishte bërë përpjekje t'i përmbyste këto struktura administrativo-ushtarake. Ato i kishte mbajtur dhe forcuar madje, ngaqë ruante baraspeshën e nevojshme politike me Bizantin, për t'ia njohur pushtetin si vasal. Bëhet e ditur se në Diokle, ia kishte lënë pushtetin princit Gjon Vladimir, të cilit ia kishte ofruar edhe dorën e vajzës së tij, Kozarës. Në Durrës, pas vitit 997, Samueli nuk kishte prekur privilegjet dhe pushtetin e parisë së qytetit, që përfaqësohej nga familja e fuqishme e Krisilëve, Gjon Krisili, *proteuon* i qytetit. Në trevën e Vlorës e të Beratit, Samueli ia besoi komandën pinjollit të familjes fisnike vendase, Elingër Frëngut. Po ashtu veproi në Devoll, Kolonjë, Vageneti, Skup, Naissus, Ulpianë e gjetkë.<sup>411</sup>

<sup>409</sup> Shih: Beck, Hans G: "Das Byzantinische Jahrtausend", München, 1991.

<sup>410</sup> Më gjerësisht shih: Faveririal, Zhan Klod: "Historia e Shqipërisë", Tiranë 2004, faqe 143-147; Златарски.В: "Отговор за България в хрониката на Симеону Метафраст и Логото", София 1908.

<sup>411</sup> По ату.



“Aleatët” që kishin gjetur Bullgarët në themën e Durrësit, të Nikopojës dhe në pjesët tjera nga Dardania e deri në Diokle, edhe përkundër titujve dhe pronave të ruajtura ose të fituara prej tyre, nuk ndikuan që ata të shikohen si të përherëshëm, meqë sundimi i tyre nuk tregonte shenja se do t’i ndihmonte një zhvillimi shoqëror dhe politik që ishte në përputhje me shfaqjen e feudalizmit të hershëm. Përkundrazi, pinjollët dhe familjet fisnike, të cilat kishin qenë pjesë e një hapësire ndarëse por edhe pajtuese midis Lindjes dhe Perëndimit prej nga kishin pasur edhe përfitime ekonomike ( tregtisë së lirë me të dy anët) por edhe të këmbimit të ideve dhe të vlerave të tjera, pra në rrethanat kur do të shohin se mund të tejkalohet kjo ngulfatje, me të shpejtë i bashkohen lëvizjes bizantine për ta kthyer pushtetin në këto anë që kishte filluar me shfaqjen e Bazilit II (976-1025), i cili do të quhet edhe “bullgarovrasës” për shkak të ashpërsisë dhe sadizmit që përdori ndaj ushtarëve Bullgarë gjatë luftimeve që kishte me ta. Disa mijëra ushtarë që kishte zënë robër në Maqedoni, të verbuar ia dërgoi mbretit Samuel në Përlep, ku i tmerruar prej saj do të vdesë, e me këtë do të fillojë edhe shpërbërja e Mbretërisë Bullgare në Traki, Ilirik dhe Dardani.<sup>412</sup>

Dhe, sikur ta kishte një përkallëzim të pashmangshëm fati Ilirikun - për të mirë, siç i kishte ndodhur mbretit Boris me rastin e ngritjes, ose për të keq, si i ndodhi mbretit të fundit, Ivan Vladislav (1015-1018), kjo do t’i ndodhë Mbretërisë Bullgare kur do të përpiket që të vendoste përsëri hegjemoninë në pjesët e saj. Mbreti i fundit bullgar mbeti i vrarë në Durrës në shkurt të vitit 1018, gjatë një sulmi ndaj këtij qyteti. Perandori i Bizantit, Bazili II (Vasili) nga Durrësi iu drejtua Ohrit, kryeqendrës së parë shpirtërore bullgare prej nga pastaj do t’i shua një nga një vatrat e qëndresës bullgare në lartësitë e Tomorit, në Vlorë e në Thesali, të cilat do t’i kthehen kishës greke.<sup>413</sup>

Edhe pse Bazili II (Vasili) rrënoi Mbretërinë Bullgare në Ilirik dhe në Dardani, ku ajo kishte arritur kulmet e saj dhe prej nga e kishte pasur rënien e pashmangshme, ngaqë nuk ia kishte dalë që të kthehej në një faktor baraspeshe midis Lindjes dhe Perëndimit, por fillimisht kishte synuar që të kthehej në një rival të Perëndimit duke synuar zhdukjen e Bizantit, ose që më vonë t’ia zinte vendin atij duke e kthyer në vasal, sapo riktheu pushtetin e Bizantit në këto pjesë, pati kujdes që kjo pjesë e Ilirikut, sërish të ruante strukturat e administrimit vendor që kishte nga koha e Heraklit dhe e Leonit III (*themat*), duke i shtuar madje në përputhje me fuqinë që paraqisnin ato në pjesët më strategjike për Bizantin

---

<sup>412</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i parë, Tiranë 2002, faqe 219.

<sup>413</sup> Po aty.

prej nga Perandoria duhej ta rikthente fuqinë e humbur nga Bullgarët. Kështu, krahas themave ekzistuese, asaj të Durrësit dhe të Nikopojës, Bazili II themeloi atë të Skupit, të cilën, si strateg ia besoi patricit dardan, David Arianitit, i cili ishte njëri ndër komandantët më të shquar të perandorit kundër Bullgarëve.<sup>414</sup>

Kjo themë, e cila përfshinte pjesët qendrore të cilat ishin të njëjta me ato që kishte provinca e Dardanisë e përcaktuar nga perandori Justinian, për rëndësinë e madhe që kishte, u ngrit në rangun e *katapanatit* dhe më vonë atë të *dukatit*. Në rangun e *katapanatit* e më vonë edhe atë *dukatit*, u ngrit edhe ajo e Durrësit, e cila ruajti statusin e bazës më të rëndësishme strategjike të Perandorisë bizantine në bregdetin Adraitik.

Krahas themave, si institucione qeverisëse dardane-ilire, Bazili II i hyri edhe organizimit të pjesëve të tjera perëndimore të Perandorisë, që ato të ishin në shërbim të rikthimit të ndikimit të Bizantit në këto anë, por që njëherësh të ishin në gjendje të pengonin ndikimet e ndryshme, veçmas të atyre që krijonte shfaqja e Arabëve dhe e Turqve, që vepronin në Lindje, e që po ashtu ia kishin dalë që të shfaqeshin edhe në Mesdhe dhe në Adriatik madje. Në përputhje me këto qëllime, Bazili II (Vasili) në tokat bullgare, në rrjedhën e poshtme të Danubit, formoi themën *Paristirionapo Paradunavon*, me kryeqytet Silistrinë, buzë Danubit. Më vonë kjo themë u ngrit në *katapanat* e më tej në *dukat*. Edhe territori i kufizuar nga Danubi dhe Sava u organizua në një themë me qendër Sirmin. Bregdeti Adriatik me Zarën në veri dhe Raguzën në jug formoi themën e Dalmacisë.<sup>415</sup>

Territoret e Dioklesë, e Zakhlumisë, Bosnjës dhe Rashës nuk u organizuan në thema, por së bashku me Kroacinë, qëndruan nën zhupanë vendas dhe formuan kështu provinca jo të mirëfillta, por zhupani (qeverisje vendore mbi bazat familjare dhe fisnore të lidhura mes veti nga një apo më shumë sosh) vasale të Perandorisë bizantine.

Si do të shihet, dy nga këto thema, ajo e Dalmacisë në Veri dhe ajo e Scupit në pjesën qendrore të Dardanisë, do të jenë me interes të veçantë, sepse ato, jash-të formës së njohur të themave, që tashmë kishin një përvojë mbi njëqindvjeçare në këto anë dhe paraqitnin instrumentet e pushtetit qendror në nivel vendor të lidhura drejtpërdrejt mes veti, *paralajmëronin shfaqjen e formacioneve të dinastive autoktone*, që do të shkojnë edhe deri te principatat vasale, të cilat, në rrethanat e reja, pas ardhjes së Sllavëve dhe vendosjes së tyre në këto anë, veçmas pas de-

---

<sup>414</sup> Më gjerësisht rreth themave shih Ostrogorski, Georg: “*Historia e Perandorisë Bizantine*”, Tiranë 2002, faqe 171,205.

<sup>415</sup> Ostrogorski, Georg: “*Historia e Perandorisë Bizantine*”, Tiranë 2002, faqe 206.

përtimeve të dinastëve rasienë (Nemanjajve) në Dardani nga fillimi i shekullit XIII deri te ai XV, nxjerrin në pah realitetet e reja të brendshme shoqërore dhe politike në këto anë, siç nxjerrin në pah edhe pozicionet politike për dhe kundër Bizantit, të cilat, me fillimin e kryqëzatave dhe shfaqjen e Normanëve, për dy shekuj me radhë, do të vënë në veprim të proceset çintegruese që do të përcaktojnë edhe rënien e Perandorisë.

## NGA THEMAT DERI TE PRINCIPATAT E PARA TË ARBNIT

Rikthimi i Bizantit në hapësirën e vet pas sundimit të gjatë bullgar, i cili ndonëse ishte larguar, kishte lënë prapa disa realitete të reja shoqërore e kulturore, që do të ndikojnë zhvillimet e mëtejme, ndër të cilat duhet dalluar vulën e kishës lindore në gjithë vendin pas kalimit të saj nën juridiksionin e patrikanës së Kostandinopojës si dhe ndryshimin e dhunshëm të strukturës etnike në disa pjesë të Ilirikut me anën e vendosjes së Sllavëve. Kështu, pasi që Sllavët kishin fituar prona të mëdha, ishin kthyer në feudalë. Dhe, me organizimin e ri të *themave* në Ilirik dhe Dardani (të Danubit dhe të Skupit) dhe të lejimit të zhupanive ose despotateve vendore (Zakhlumisë, Bosnjës dhe Rashës), ishte hapur çështja e një rivaliteti midis *pushtetit autonom*, të bazuar në despotate, bartës të të cilëve ishin ardhësit Sllavë të shumtën të ilirizuar ose të përzier me ta, dhe *atij vendor* të lidhur me pushtetin qendror të *themave* në të cilin, me statusin e qytetarisë perandorake “*romaios*” përfshiheshin popujt shtetformues të Perandorisë (Ilirët, Latinët dhe Helenët), rivalitet ky që si do të shihet, do të kthehet në një shkas për dobësimin dhe së fundit edhe për rënien e Perandorisë.

Në të vërtetë pranimi i formës dyshe të organizimit administrativ të vendit me *themat* centraliste dhe despotatet (vetëqeverisje vendore), solli konfliktet e pashmangshme midis tyre, meqë nuk ishte fjala për “përzierje” kompetencash midis *themave* që përfaqësonin pushtetin vendor të lidhur me qendrën dhe autonome vendore, por më tepër bëhej fjalë për ndryshimin e pozitës shoqërore dhe sociale të klasave drejtuese, pushteti i të cilave nuk matej më nga pikëpamja administrative, por e pronës. *Strategët* që udhëhiqnin *themat*, ndonëse ushtarakë të lartë me merita për ruajtjen e stabilitetit të vendit, kishin filluar të humbnin pushtetin por edhe prestigjin karshi feudalëve dhe despotëve vendorë, të cilët vepron-

nin të pavarur në kuadër të feudeve të tyre, ku edhe pasuroheshin me të shpejtë dhe kështu shfaqeshin si faktor i njëmend force.<sup>416</sup>

Shkas për këtë ndryshim të madh ishin vetë raportet shoqërore brenda Bizantit, të cilat lidheshin me zhvillimin e marrëdhënieve feudale në të dhe prodhonin pasoja të ndryshme, që preknin gjithë shoqërinë, veçmas shtresën e mesme dhe atë të ulët, që shpronësohej nga pronat, të cilat kalonin në duar të feudalëve të mëdhenj. Mund të thuhet se pas vdekjes së perandorit Bazil II dhe fundit të dinastisë maqedonase, me Konstantinin IX Monohomos (1042-1055) mori fund epoka e karakterizuar nga prona e vogël e *bujkut-ushtar (stratiotit)*. Kjo formë e pronës, që mbështetej mbi konceptin e *themave*, e ku faktor kryesorë ishin ushtarakët vendorë, në të vërtetë gjatë dy shekujve të fundit, kishte qenë shtylla kryesore e pushtetit bizantin në pjesët e Ilirikut por edhe ato të krahinave Lindore, ku format e autonomive administrative me anën e provincave që i kishte filluar perandori Dioklecian dhe i kishte vazhduar Konstantini i Madh për të arritur nivelin me të lartë me reformat e Justinianit, ishin zëvendësuar me një mbikëqyrje ushtarake qendrore. Por gjatë pushtimit bullgar, kur kishin ndodhur ndryshime të dhunshme në përbërjen e popullatës (vendosja e Sllavëve në disa pjesë si dhe faktorizimi i tyre ekonomik në dëm të vendësve me anën e pronave të fituara nga luftërat pushtuese), ajo kishte filluar të humbte rëndësinë që kishte.

I vetëdijshëm për këtë realitet të ri, perandori Bazil (Vasili), ndonëse kishte rikthyer *themat* e mëparshme, atë të Durrësit e Nikopojës dhe atyre u kishte shtuar edhe dy të tjera: atë të Skupit (Shkupit) dhe të Dalmacisë, të cilat pak më vonë do t'i ngre në shkallën e *katapanateve* dhe të *dukateve*, megjithatë pranimi i despotateve vendore (të Dioklesë, Zakhlumisë, Bosnjës dhe Rashës) me popullatë të përzier, ku dominonin Sllavët e shpërblyer me prona qysh nga koha e Heraklit dhe të pasuruar edhe gjatë kohës së pushtimit bullgar, hapte rivalitetin midis *autonomive vendore* - të dytave dhe atyre të mekanizmave qendrorë të nivelit vendor - të të parave, të cilat ndonëse do t'u ngrihet niveli deri te ai i *dukateve*, prapë se prapë thellonte hendekun e dallimeve midis feudalëve vendorë dhe shtresës ushtarake dhe asaj fisnike, që mbështetej nga perandoria dhe kishte përcaktime bizantine. Kjo pra zhvendoste qendrën e pushtetit nga faktorët e deritanishëm, tek ata, që nuk i

---

<sup>416</sup> *Strategët* ishin ushtarakë, të cilët Perandoria i emëronte administratorë të themave. Kishin pushtet ushtarak, por edhe civil. Të shumtën drejtonin administratën dhe ekonominë vendore, por bartnin edhe barrën e organizimeve ushtarake në përputhje me interesat perandorake. Nga shekulli XI e këndej roli i strategëve do të bjerë, kështu që do të fillojë edhe dobësimi i pushtetit qendror në dobi të despotëve vendorë (kryesisht Sllavë), të cilët shfaqenin pretendimet për t'u mvetësuar nga Perandoria. (Shih: Georg, Timothy E: "A History of Bizantium", Oxford, 2008).

nënshtroheshin as komandës, as drejtimin centralist, por fuqisë ekonomike, që e përthithnin në dëm të shtresave shoqërore që varfëroheshin.<sup>417</sup>

Ky zhvillim, i cili kishte formën e piramidës, pasqyrohet edhe në qarqet më të larta perandorake dhe në vetë strukturat e saj, me çka *pushteti i deritanishëm ushtarak* luhet nga ai i *aristokracisë feudale dhe burokratike* të Kostandinopojës në rritje, e cila kishte nevojë për financa, që i siguronte nga feudalët e pasur, gjë që ishte e pritshme që të anonte nga ata. Ndërkohë që ky ndryshim menjëherë u pasqyruar edhe te shtresa e *bujqve-ushtarë (stratitotëve)*, të cilët jo vetëm që varfëroheshin, por ata humbin edhe rëndësinë shoqërore që kishin, që e gjitha u kuptua si një gjendje e diskriminimit të faktori vendor dhe mbrojtës perandorak, siç ishte shtresa ushtarake dhe favorizimit i faktorit feudal nga despotatet bullgare-sllave, të cilat forcoheshin nga të gjitha pikëpamjet në dëm të të parit.

Kjo mjaftoi që në *themat* e Durrësit dhe të Nikopojës të shfaqeshin pakënaqësitë e para, por edhe lëvizjet kryengritëse, të cilave do t'u japë shkas të mirë ngritja krye e Grigor (Gjergj) Maniakut, komandant i Sicilisë, i cili në vitin 1043, në luftë kundër pushtetit qendror, atje, me ndihmën e trupave, shumë prej tyre të ardhur nga Arbëria, shpallet perandor. Kronisti bizantin M. Attaliati thotë se me një ushtri të tij, ku bënin pjesë romej dhe albanë (*ρομαιος ω αλβανοι*), ai zbarkoi në Durrës dhe, gjithnjë sipas kronistit bizantin, Maniaku, pasi arriti suksese të rëndësishme në Maqedoni, në rrugë e sipër për në Kostandinopojë, iu drejtua Thessalonikit që ta merrte dhe sigurisht se kësaj do t'ia dilte po mos të ishte një vrasje fatkeqe që e gjet në udhë e sipër.<sup>418</sup>

Kryengritja e Maniakut ashpërsoi marrëdhëniet e *themës* së Durrësit me pushtetin qendror, meqë ajo tashmë ishte kthyer në një terren pjellor për ngjarje të tilla, ku në një rën anë thyheshin raportet me perandorinë dhe në tjetrën anë ato me qeverisjet vendore të drejtuara nga despotatet sllave, që gjithnjë e më shumë forcoheshin. Këtë më së miri e pasqyron një shënim i historianit bizantin të shekullit XI Mihal Attaliati, ku thuhet se në atë kohë Arbrit, dikur aleatë të Perandorisë Bizantine (*symmachio*), u bënë “papritur” kundërshtarët e saj (*polemioi*).<sup>419</sup>

Ato që thotë historiani Ataliati rreth “aleatëve” të Perandorisë Bizantine, që “papritur” kishin humbur besimin, pra të kthimit të tyre në “kundërshtarë” (*polemioi*), duken më shumë një përshkrim sesa shprehje e një gjendje më të thellë, e cila do të përcjellë raportet e ardhshme të krizës së brendshme perandorake. Çësh-

---

<sup>417</sup> Shih Ostrogorski, Georg: “*Historia e Perandorisë Bizantine*”, Tiranë 2002, faqe 205.

<sup>418</sup> Shih M. Attaleiatae “*Historia*”, Bonnae, 1853, faqe 18.

<sup>419</sup> Po aty.

tja e *themave* si dhe shpronësimi i tyre nga pushteti mbi njëqindvjeçar dhe ngritja e aristokracisë feudale, që ishte burim i të ardhurave, por njëherësh edhe përcaktues i raportit të forcave, nuk ishte gjithaq çështje e raporteve aleat-kundërshtar, që ndryshonin në përputhje me rrethanat e caktuara, por paraqiste një ndryshim në njërën anë midis atyre që Perandorinë Bizantine e kishin pjesë të vetëdijes së tyre shtetërore, siç ishin Arbrit (pasardhësit e Dardano-Ilirëve) dhe Helenët, të cilët e kishin ndërtuar atë dhe zhvilluar deri në atë shkallë dhe, në tjetrën anë, të pushtuesve nga lindja: Sllavëve, Bullgarëve e të tjerë, të cilët kishin filluar ta pushtonin Perandorinë nga brenda dhe ta rrënonin me pretendimet që ta kthenin në perandori të tyre. Kështu do të veprojnë fillimisht Bullgarët dhe pastaj zhupanët e Zakhlumles, Teruniase më vonë të Rashës pasi që do ta pushtojnë atë në shekullin XII e deri në atë XIV (nga Nemanja, Uroshi II, Stefani e deri te Dushani).<sup>420</sup>

Ata, do ta luftojnë me të gjitha mjetet pushtetin qendror të Bizantit të shumtën me kurorën e tij, pa ngurruar që të fusin në lojë edhe kundërshtarët e saj, sidomos Perandorinë Perëndimore, e edhe vetë Osmanët, me ç'rast, me ta, do të lidhin shumë marrëveshje të fshehta e më vonë edhe të hapura vasaliteti kundër Bizantit, por edhe Perëndimit në përgjithësi.

Ky fakt, i anashkaluar të shumtën qëllimisht, nxjerr në dritë themeluesit dhe pushtuesit e një ngrehine të madhe perandorake siç ishte Bizanti, siç nxjerr në dritë edhe mbrojtësit dhe rrënuesit e saj të njëmendët, rolet e të cilëve jo vetëm që shpesh ngatërrohen, por edhe interpretohen gabimisht. Sllavët dhe barbarët tjerë të ardhur nga veriu dhe lindja, të faktorizuar shpejt nga shkaku i fuqisë së madhe njerëzore, asnjëherë nuk e kishin pranuar rendin e mirëfilltë perandorak. Sepse, ai nënkuptonte emancipim dhe nënshtrim shtetit, rregullave e ligjeve, siç kërkonte edhe kulturë shoqërore dhe kreativitet. Se ishin jashtë këtyre koncepteve dhe dëshironin t'u mbeteshin besnikë prirjeve barbare, këtë e tregon më së miri pranimi shumë i vonë i krishterimit (nga shekulli nëntë e deri në të dhjetin), paçka se edhe kur do ta pranojnë, ishte më tepër çështje e përdorimit të tij për pushtet, pse e kishte perandoria dhe krishterimi ishte bashkëpushtetar i pashmangshëm i çfarëdo pushteti i cili fillonte "nga poshtë", pra nga popullata ku edhe fuqizohej.

Se krishterimi do të mbetet mjet për pushtet dhe madje nga kjo pikëpamje do t'i shtohet edhe pesha, këtë do ta tregojnë prirjet e fiseve sllave dhe të Bullgarëve që të bëjnë hesape me të, me lëvizjen nga njëra kishë te tjera (nga ajo perëndimore te lindorja dhe anasjelltas), e theksuar veçmas nga mesi i shekullit të

---

<sup>420</sup> Shih: Porphyrogenitus, Constantine: "*Corpus Scriptorum, Historia Byzantinae*", Bonne, MDCCXI, f. 168-173 dhe "*De Administrando Imperio*", Washington, 1967; Harworth, H.H: "*The Spread of the Slaves*", f. 67-76.

dhjetë e këndej, pikërisht te ato despotate në Ilirik, ku tashmë sllavët kishin filluar të faktorizoheshin, (në Diokle, Zaxhlumi, Bosnje e deri në Rashë), të pranuar dhe të njohura nga Bizanti pas rrënimit të mbretërisë bullgare nga perandori Bazil (Vasili) II.<sup>421</sup>

Në këto rrethana, despotatet sllave në Ilirikun Qendror, marrin herë anën e njërit e herë të tjetrit kryq, të shumtën duke lidhur aleanca që shkonin në dobi të forcimit të tyre dhe të dobësimit të pushtetit qendror të Bizantit.

Kjo gjendje kulmoi nga mesi i shekullit XI për t'u kthyer në një arenë të hapur, ku thyheshin interesat e Lindjes dhe të Perëndimit, gjë që nuk është e rastit pse në vitin 1054, mbi këtë "garë" do të kalojë edhe kufiri i ndarjes së kishave, që për pasojë pati jo vetëm rreshtimin e principatave në përputhje me këtë kufi dhe lëvizjen e tij, por edhe luftën e ashpër për mbijetim midis Bizantit dhe Perandorisë Perëndimore, që me shfaqjen e kryqëzatave, gjithnjë e më shumë do të bartet në këtë pjesë, që edhe më të ashpër dhe të përgjakshme do ta bëjë shfaqja e Osmanëve. Siç dihet, Osmanët, jo vetëm që do të përfshihen në të, por edhe do të përfitojnë prej saj, duke ua hapur rrugën depërtimeve dhe pushtimeve, që Bizantin do ta prekin nga fillimet e shekullit njëmbëdhjetë për t'u kthyer në pushtues të kësaj pjese nga fillimet e shekullit katëmbëdhjetë prej nga pastaj ata do t'i drejtohen edhe Europës Qendrore.

Në paralojën e këtyre zhvillimeve, pra që Bizanti të mbrohet duke u ndryshuar kreu i tij nga poshtë-lartë, do të përfshihen Arbrit dhe vendet e tyre në pjesën më të rëndësishme të Bizantit, ku mund të përcaktohej fuqia e njërit apo tjetrit kryq e me këtë edhe raportet politike midis Lindjes dhe Perëndimit.

Një nga përpjekjet e para që do t'ia hapë rrugën luftës për pushtet nga ushtarakët vendorë, ishte edhe ajo e strategut Niqifor Brieni. Në vitin 1077 ai ngrehu krye kundër Kostandinopojës. Ky strateg ishte i njohur për patriotizmin e tij perandorak në luftërat e shumta që kishte bërë kundër zhuganëve Sllavë në Veri, pa përjashtuar këtu edhe luftën kundër anijeve normane në Adriatik. Niqifori u vetëshpall perandor dhe njësoj si kohë më parë Gregor Maniaku u nis për në Kostandinopojë për ta rrëzuar perandorin Mihail VII Dukas. Rrugës iu bashkuan edhe fisnikë të tjerë dhe shtresa e shpronësuar e stratiotëve të *themave*, të cilët kërkonin shpagim të përgjakshëm për këtë. Te dyert e Adrianopojës atij do

---

<sup>421</sup>Shih: Stein. E: "Untersuchungen zur spätbyzantinischen Verfassungs und Wirtschafts Geschichte", 1928; Vasiliev, A.A. „History of the Byzantine Empire“, Madison 1952.

t'i vijë fundi nga ushtria perandorake që e komandonte Aleks Komneni. Pas katër vitesh, më 4 prill 1081, A. Komneni shpallet perandor i Bizantit.<sup>422</sup>

Hipja e gjeneralit të famshëm perandorak në fronin e Bizantit, bëhet pas një sprove me një dukë të Durrësit, Niqifor Baziliaku, i cili kishte zënë vendin e Niqifor Brienit. Duke folur për kryengritjen që duka i Durrësit, Niqifori, ndërmori më 1087 kundër Kostandinopojës, thotë se në ushtrinë e tij morën pjesë trupat romeje, bullgare dhe arvanite (Είχε ἄρα καὶ ρωμαίων στρατιωτικόν, βουλγαρῶν τε καὶ **αρβανιτῶν**).<sup>423</sup>

Për pjesëmarrjen e Arbanitëve në kryengritjen e dukës së Durrësit, flet edhe kronisti tjetër bizantin, G. Kedrenos. Ai thotë se “duka i Durrësit mbloodhi luftëtarë nga të gjitha vendet e themës së tij, të cilëve iu bashkuan edhe vullnetarë frëng, që ia dërgoi peshkopi Theodorios i Deabolisit (Devollit), i cili ndodhej në Itali”.<sup>424</sup>

Baziliaku (Vasili), si përfaqësues i aristokracisë ushtarake perëndimore në përpjekjet e tij për ta marrë fronin e Kostandinopojës, kishte rivalin ushtarak nga Lindja, Niqifor Botonianin, i cili ia doli, që në saje të mbështetjes që siguroi nga Sulajmani, nipi i sulltanit, Alp Arslan, të fitojë fronin perandorak.<sup>425</sup>

Mbështetja që mori Niqifor Botoniani plaku nga Turqit dhe ajo e mëvonshmeja e Melisenit, në të vërtetë, atyre ua lehtësuan rrugën e pushtimit të Azisë së Vogël, siç do t'ia hapë edhe rrugën depërtimit të shpejtë të islamit në drejtim të Perëndimit. Si do të shihet, në disa çaste, kisha e Kostandinopojës, pushtimet osmane do t'i shfrytëzojë për shtrirjen e ndikimit të vet në dëm të kishës romake. Me këtë mund të thuhet se zë fill dyshimi historik, jo pa mbështetje, që kishën lindore, në luftë kundër katolicizmit, e ngarkon me anatemën e aleancave herë të hapura e herë të fshehura me turqit, si një strategji që doli në shesh veçmas me vasalitetin e princave ortodoksë me osmanët pasi që ata të depërtojnë në Ilirik.

Sidoqoftë, rreth vitit 1080 Sulajmani mbikëqyrte gjithë territorin e Azisë së Vogël, nga Kilikia në Helespont, ku në këtë territor të lashtë bizantin themeloi sulltanatin e *Ar Rumit*, pra “*sulltanatin roman*”.<sup>426</sup>

---

<sup>422</sup> Më gjerësisht shih: Leb, B.: “*Niecephore III Botaniates (1078-1081) et Marie d’Lanie, Actes du VI Congres Intern. D’Etudes Byz.*” V/1950.

<sup>423</sup> Shih M. Attaleiates: “*Historia*”, Bonnae, 1853, faqe 18.

<sup>424</sup> Shih Frashëri, Kristo: “*Etnogjeneza e Shqiptarëve*”, Tiranë 2013, faqe 232.

<sup>425</sup> Shih: Ostrrogorski, Gerog: “*Historia e Perandorisë Bizantine*”, Tiranë 2002, faqe 243; Neumann: “*Die Weltstellung des Byzantinischen Reiches vor den kreuzzügen*”, Leipzig 1894.

<sup>426</sup> Shih: Laurent, J: “*Byzance et les origines du Sultanat Roum*”, 1930; Wittek, P: “*Deux chapitres de l’histoire des Turcs de Roum*”, 1936; Cohen, C: “*La premiere penetration turque en Asie Neneure*”; Laurent, J: “*Byzance*



Kjo ka rëndësi të theksohet pse humbjet në Lindje, të cilat do të jenë të paktë dhe fatale madje, Bizanti do të kërkojë t'i zhdëmtojë disi me anën e riformimit përtej Bosforit, pikërisht në hapësirën e Ilirikut, ku tashmë, me krijimin e dy *themavetë* reja (asaj të Dalmacisë dhe të Skupit) dhe, veçmas me lejinimin e despotateve të pavarura: të Dioklesë, të Bosnjës, të Zaklhumisë dhe të Rashës, gjendja kishte ndryshuar dukshëm sa nga kriza e *themave*, e po aq edhe nga ndërhyrja e shteteve bregdetare (Venedikut dhe Gjenovës) për sa më shumë aleatë tek pretendentët e rinj në brigjet e Adriatikut dhe të Mesdheut.<sup>427</sup>

Këtu nuk duhet harruar edhe ndërlikimin e Selisë së Shenjtë për t'i tërhequr pas zhupanët dhe feudalët Sllavë dhe faktorët tjerë vendorë, të cilët kërkonin që të përfitonin me lojën e tyre me kishat, ani pse këto dy çështje kishin të përbashkët pakënaqësinë ndaj pushtetit qendror, por jo edhe qëllimet, sepse aristokracia ushtarake nuk kërkonte ta rrëronte Bizantin veçse ta merrte fronin perandorak, që ta drejtonte për t'ia ruajtur tërësinë për aq sa ishte e mundur. Ndërsa zhupantë dhe princat Sllavë kërkonin, që ta kthenin atë mundësisht në një *Sllavi* ose që me anën e sa më shumë principatave të pavarura, ta venin nën shtetull, pa ngurruar që për këtë të lidheshin me Perëndimin.<sup>428</sup>

Ky zhvillim me kthesa të ndryshme, që kishte edhe dramën e brendshme si edhe të tjerët deri atëherë, sfidoi Ilirikun edhe më shumë, sepse pas ndarjes së kishave (1054) kjo vijë kalonte nëpër trupin e saj, ku përkrahësit dhe përfituesit e Bizantit, do t'i nënshtrohen një lufte e cila kryekreje do të hapet midis Bizantit dhe Perëndimit, e cila do të zhvillohet në rrethanat e fillimit të epokës së feudalizmit ushtarak, që karakterizohet nga ekspansioni i pronës ushtarake të kushtëzuar (*pronies*), ku tashmë ishte futur në lojë edhe një faktor tjetër "i jashtëm" shumë i fuqishëm – Normanët. Shfaqja e Normanëve ndikoi që Perëndimi i molitur të këndellej, duke lëvizur drejt Lindjes, ndërsa Bizanti me shumë telashe të përballet me pushtuesit e rinj nga Perëndimi, që bashkë me ata nga Lindja (turqit), ia krijojnë rrethanat për t'u shembur nga brenda dhe nga jashtë.

Në këtë zhvillim të ri me shumë e shumë akterë të dukshëm dhe të padukshëm të skenës dhe të prapaskenës, protagonistin kryesor mbetet Bizanti dhe ngrehina e tij e gjykuar të shembej, ngaqë po i ikte koha, ndërsa në shesh të kësaj

---

*et les origines du Sultanat Roum, Melanges Diehl* I, 1930; Wittek, P: "Deux chapitres de l'histoire des Turcs Roum" në BYZ, II/1936; Cohen, C: "La premiere penetration turque en Asie Meneure".

<sup>427</sup> Shih Grosse. M: "Römische Militar Geschichte von Gallienus zum Begin der byzantinischen Themeverfassung", Berlin 1920.

<sup>428</sup>Herrin, Judith: "Byzantium", Munchn, 2008.

ndeshjeje, sërish do të kthehet Iliriku Jugor, tashmë si *Arbëri Bizantine*, ku Perëndimi shihte fillimin e vet vendimtar drejt Lindjes, ndërsa Lindja digën mbrojtëse kundër Perëndimit, që duhej mbrojtur me çdo kusht.

Ndarja administrative në dy pjesë (në shekullin IV gjatë kohës së perandorit Teodos), si dhe ajo më e reja e kishave, tashmë po kthehej në një ndarje shoqërore, kulturore dhe politike ndër më të mëdhatë e kohës, që pak më vonë do të kthehet edhe në kufi të ndarjeve të qytetërimeve botërore.<sup>429</sup>

Megjithatë, në këtë përpëlitje, ishte perandori Aleks Komneni (1081-1118), gjenerali më i suksesshëm bizantin i të gjitha kohëve, që me fuqizimin e aristokracisë ushtarake, ia doli që përkohësisht të parandalojë rrënimin e perandorisë nga trysnitë e dyanshme me të cilën kishte filluar të përballej (nga Lindja, me Turqit dhe nga Perëndimi me Normanët), por jo edhe ta shmangë atë. Me vepërimet e Komnenit, Perandoria tashmë e ndryshkur, ia doli të përballojë nënçmimin që përjetoi mu në zemër të saj, në Kostandinopojë, pasi që ajo të jetë pushtuar nga kryqtarë perëndimorë dhe rrënuar deri në themel, por jo edhe fundin e saj të plotë, dy shekuj më vonë nga Osmanët.<sup>430</sup>

Si ushtarak i njohur, Aleks Komneni do të tregohet edhe diplomat i shkathtë në disa drejtime për ta shfrytëzuar ndihmën e vendeve perëndimore, veçmas fuqive bregdetare, Venedikut dhe Gjenovës për të përballuar rrezikun norman që vinte nga Veriu, por edhe për të shfrytëzuar euforinë e lëvizjes së kryqëzatave, që kishte shpërthyer në vendet e Europës për të çliruar varrin e Krishtit në Jerusalem, për parandalimin e Turqve në Lindje, të cilët ia kishin shkëputur shumë pjesë Perandorisë në Azinë e Vogël dhe çështje ishte se kur ata do t'i afroreshin Kostandinopojës.<sup>431</sup>

Si çështja e parë - rreziku norman dhe ballafaqimi me të, dhe çështja e dytë - kryqëzatat (tetë sosh), me të cilat Bizanti pati punë gjatë dyqind vjetëve të ardhshme dhe ato do të bëhen shkak edhe për rënien e tij, pikënisje patën pjesën qendrore të Ilirikut dhe të Dardanisë e të Maqedonisë antike, pastaj Epirin si dhe bregdetin, hapësirë kjo, që do të kthehet në luftë të vazhdueshme dhe tepër të ashpër midis Bizantit dhe Perëndimit.

---

<sup>429</sup> Shih: Honigmann, E: *“Die Ostgrenze des byzantinischen Reiches von 363 bis 1071 nach griechischen, arabischen, syrischen und armenischen Quellen”* (Corpus Bruexellense Hist, Byz. III), Bruxelles 1935.

<sup>430</sup> Shih: Herrin, Judith: *“Byzantium”*, Munchn, 2008.

<sup>431</sup> Shih Chaladon, F: *“Essai sur le regne d’Alexis I Comnene (1081-1118)”*, Paris 1900.



## KAPITULLI I TRETË

### MIDIS BIZANTIT DHE PERËNDIMIT

#### KRYQËZATAT KATOLIKE DHE PUSHTIMET RASIENE

Gjendja e papërshtatshme e një pjese të vendeve të Ilirikut Qendror (hapësirës së dikurshme të Dardanisë antike dhe Maqedonisë), në rrethanat e ndarjes së kishave që nga mesi i shekullit XI, filloi të ndryshojë me të madhe pas humbjes së Mbretërisë Bullgare dhe shfaqjes së Normanëve dhe depërtimit të tyre të fuqishëm nga veriperëndimi dhe jugperëndimi, kur ata një nga një i pushtuan disa nga mbretëritë e lodhura europiane në veri: atë angleze, pastaj ato të Spanjës dhe së fundi mbretëritë bregdetare të Mesdheut nga Gjenova e deri në Sicili.

Me shfaqjen e Normanëve dhe vullnetin e tyre të madh për pushtime, mbretëritë dhe qytetet bregdetare europiane nga veriorët fitojnë një energji të re, me të cilën do të ringjallin shumë nga ambiciet e tyre të dikurshme thujse të fikura për të lëvizur drejt shtrirjes së pushtetit kah Lindja. Për t'u vënë në veprim vullneti për pushtime të reja, në bashkëpunim me papatin dhe frymën e katolicizmit që, krahasuar me ortodoksët, po ashtu prej kohësh ndodhej në një zbrapsje, Normanët “rizbulojnë” Tokën e Shenjtë, pra Palestinën, dhe varrin e Jezu Krishtit atje, me ç'rast, ai duhej të kthehej, nga Turqit Selxhukë, në duart e të krishterëve. Kështu, Normanët bashkë me Vatikanin dhe republikat e Adriatikut, po edhe ato të Mesdheut, “zbuluan” kryqëzatat për rikthimin e vendeve të shenjta në Lindje dhe kjo do të marrë përmasat e valëve të mëdha të mobilizimit të të gjitha shtresave shoqërore nga vendet e Veriut të Europës, veçmas të atyre të etshme që aventurën ta kthenin në një mjet përfitimi, të cilat do të përfshihen në një fushatë të paparë drejt vendeve të Lindjes, fushatë kjo që do të zgjasë për më shumë se një shekull e gjysmë me shtatë kryqëzata të mëdha, që të shumtën për “sukses” kanë pasur rrënimet e papara andej nga kanë kaluar dhe mosarritjen ta kthejnë në mbikëqyrje të përhershme Tokën e Shenjtë bashkë me tempujt e krishterë në Jerusalem.

Kështu, mund të thuhet se koha e kryqëzatave shënon kohën e shfrimeve ndër më të egrat, që të shumtën do të lënë pas gjurmë gjaku të pashlyera, ku në masë të madhe pësuan vetë vlerat e qytetërimit të krishterë, sidomos ato që do t'i bëhen vetë Kostandinopojës gjatë dy pushtimeve gjatë kryqëzatës së katërtë. Sa i përket rrezikut norman, që kërcënonte nga të gjitha anët, kryqtarëve dhe rolit të tyre që do të luajnë së paku gjatë Kryqëzatës së Parë (1097-1099), ka shumë shenja se Aleks Komneni, jo vetëm e kishte dëshiruar si të tillë, por edhe që e ka nxitur në forma të ndryshme, meqë parulla e “luftës së shenjtë” për çlirimin e varrit të Jezuit në Jerusalem vinte nga ai. Kjo parullë mobilizonte shtresat e gjera të të krishterëve anembanë kontinentit të vjetër ku katolicizmi kishte fjalën kryesore, gjë që linte pas dallimet midis kishave, që ishin të mëdha dhe të dëmshme për të, por ajo, njëherësh, krijonte rrethana që gjithë ajo energji e madhe të derdhej në Lindje, kundër turqve, në mënyrë që me vendosjen e tyre në Azinë e Vogël, ata të ktheheshin në një digë mbrojtëse.<sup>432</sup>

Duket se kjo do të jetë motivuese jo vetëm për shtresën e madhe të aventurierëve të shumtë, të cilët mezi prisnin të përfitonin diçka, por joshëse shfaqej edhe për feudalët, të cilët bënin hesap se në pjesën lindore të Azisë së Vogël, ku kishte prona të mëdha dhe kushte klimatike për bujqësi, do të pasuroheshin. Kjo çështje do të ketë qenë edhe hesap i shumë klerikëve katolikë, të cilët vlerësonin se euforia e kryqtarëve në lindje, në radhë të parë duhej shfrytëzuar për zhvendosjen e një pjese të madhe të katolikëve në ato pjesë, e cila do të ishte në gjendje që të rriste ndikimin e kishës perëndimore në Lindje, që tashmë ishte përjashtuar fare në ato anë.

Para se të dalin në pah veprimet e kryqtarëve si dhe gjithë ato zhvillime që lidhen me ta dhe sjelljen e tyre, duhet thënë se Bizanti fillimisht do të përballet me sfidën normane, e cila nuk ishte as e re e as e panjohur, meqë ata tashmë ishin kthyer në zotërues të Mesdheut, dhe se Selia e Shenjtë, por edhe qytetet bregdetare, ndodheshin nën tryshninë e pushtimeve të tyre.

Normanët, si fuqi vitale e zbritur nga Veriu që një nga një kishin përmbysur ose pushtuar mbretëritë e vjetra europiane, do të dalin në Mesdhe. Të kryesuar nga i famshmi Rober Guiskard, i cili kohë më parë, pasi ia kishte dalë që të bashkojë të gjitha zotërimet e princërve normanë të Italisë së Jugut dhe krijoi një mbretëri të fuqishme, menjëherë i hodhi sytë në anën tjetër të Adriatikut. Tek e

---

<sup>432</sup> Shih: Neuman, C “*Die Weltstellung des byzantinischen Reiches vor des Kreuzzügen*”, Leipzig 1894; Schlumberger, G. „*Un empereur byzantin au X siecle*“, Paris 1896; Vasilieve, A. A. „*History of the Byzantine Empire*“, Madison 1952.

fundit, për Guiskardin, i cili tashmë kishte shprehur haptas pretendimet për kuro-rën Perandorake të Bizantit, synim kryesor shfaqej marrja e Durrësit, që hapte portat drejt Kostandinopojës.

Për vendet në Ilirikun Perëndimor dhe atë Qendror, që përfshinte hapësirën e Epirit, të Dardanisë dhe të Maqedonisë antike, dhe rrethanat në të cilat ndodhe-shin fillimisht temat (njësi të pavarura administrative-ushtarake nën Bizantin, siç ishin ajo e Durrësit në shekullin VIII dhe ajo e Nikopojës në shekullin IX, e Skupit dhe e Naissusit në shekullin XI/XII) dhe më vonë edhe bujaritë dhe feudet e ndara në të dy pjesët e botës së përçarë dhe tashmë të armiqësuar krishtere, depërtimi i Normanëve dhe fillimi i kryqëzatave kishte një rëndësi të veçantë. Sepse, në njërën anë zgjonte shpresën se Normanët kishin vënë në lëvizje një energji të madhe, e cila në radhë të parë do të shfrytëzohej që kufiri i ndarjes së kishave të shtyhej këndeje në drejtim të Lindjes, në mënyrë që hapësira e Perëndimit dhe me këtë edhe ajo e katolicizmit të arrinte deri te Kostandinopoja dhe, në tjetrën anë, do të krijojë vetëdijen se edhe Arbrit, tashmë të liruar nga limitet e konceptit të qytetarisë bizantine *romaios*, që e kishte humbur kuptimin e mirëfilltë dhe si e tillë kishte rënë thuajse e tëra nën mëshirën e Sllavëve, mund të bëhen pjesë e këtyre ndryshimeve dhe në to të shohin edhe interesin e tyre në përputhje me zhvillimet që do të marrin drejtim të pandalshëm. Mbreti Rozher i Normanëve, nuk fshehte qëllimet, që si thoshte, të kthehet Roma e vjetër.<sup>433</sup> Kjo në të vërtetë ishte më tepër qërim hesapesh me Perandorinë Lindore se sa luftë për kthimin e varrit të shenjtë dhe Palestinës, siç gjendej në betimin e kryqëza-tave, gjë që e gjitha do të kthehet në një përçarjeje të mëtutjeshme midis të krishterëve.

Në këto rrethana, vërehet se depërtimi i Normanëve në Ilirik dukej se para-qiste një zhvillim pozitiv për t'i dhënë fund ngërçit të krizës së Bizantit që pasqyrohej me humbjen e autoritetit të pushtetit qendror të zëvendësuar me luftërat e feudalëve dhe princave vendorë për pushtet sa më të madh e përcjellë me pasiguri dhe kriza shoqërore. Kjo u pasqyrua me pranimin e vasalitetit të Normanëve nga ana e princave vendorë, duke filluar nga kontët e Durrësit për t'u bartur pas-taj edhe në Veri dhe brendi te dera princore e Dioklesë, e cila pranoi që t'u bashkohet kryqëzatave me kusht që ato të sigurojnë shtrirjen e katolicizmit kah lindja.<sup>434</sup>

---

<sup>433</sup> Ostrogorski, Georg: “*Historia e Perandorisë Bizantine*”, Tiranë 2010, faqe 140

<sup>434</sup> Po aty.

Meqë gjendja e re premtonte heqjen e kufirit të ndarjes, ose së paku e shtynte thellë kah Lindja, dhe kjo hapte një mundësi të mirë drejt kapërcimit dhe bashkimit me pjesën perëndimore e cila në rrethanat që ishin shfaqur pas ndarjes së kishave, shumë më natyrshëm i lidhte ata ekonomikisht dhe politikisht me këtë pjesë të botës se sa përkatësia lindore, e cila, nga luftërat e shumta dhe shfaqja e principatave të shumta, kishte filluar të rrudhej, të mos jetë më në përmasat e mirëfillta perandorake. E tillë shihej edhe nisma e Papës Grigori VII, midis udhëheqësve të Normanëve, Guiskardit dhe Mihalit të Dioklesë, ku u lidh një aleancë ushtarake kundër Bizantit, në të cilën u futën edhe disa vende të tjera të Ilirikut perëndimor si Republika e Raguzës dhe Mbretëria e Kroacisë që ishin nën ndikimin e kishës katolike.<sup>435</sup>

Jashtë kësaj aleance kishte mbetur Venediku, i cili sado që ishte kundërshtar i rikthimit të Bizantit, po ashtu, te forcimi i Normanëve dhe pretendimet e tyre për t'u bërë zotë të Lindjes, shihte rrezikimin e interesave jetike, veçmas kur nga forcimi i tyre mund të fitonte Gjenova dhe qytetet e tjera mesdhetare, të cilat do t'ia rrezikonin pozitën e mbikëqyrjes së lundrimit dhe e tregtisë në Mesdhe, prej nga mallrat e saj shkonin dhe vinin edhe këndeje në Azi dhe Afrikë. Madje, si do të shihet, kur Normanët do të fillojnë zbarkimin e tyre në pjesën tjetër të Adriatikut, flota e Venedikut iu përgjigj thirrjes së Aleks Komnenit për t'u futur në luftë kundër tyre, me ç'rast kjo ua hapi udhën disa aleancave që Bizanti do të lidhë me ta, që si do të shihet pos një tagri të madh për Kostandinopojën, ato u përcollën edhe me pasoja të shumta, sepse prapa tyre gjithnjë do të fshihen dredhitë e njohura të republikës detare të Adriatikut, që ajo i përdorte nga situata në situatë, pa hezituat që ato t'i thyejë ose t'i kushtëzojë në përputhje me interesat e saj.

Sidoqoftë, në maj të vitit 1081 ushtritë normane të kryesuara nga i biri i Guiskardit, Boemundi, zbritën në gjirin e Vlorës, prej nga do të pushtojnë këtë qytet dhe pastaj do të marrin edhe Jerikun dhe Kaninën për të arritur deri në Butrint, ku do të bashkohen me ushtritë e Guiskardit, i cili kishte pushtuar Korfuzin. Atyre do të mundohet t'ua presë rrugën e bashkimit perandori i Bizantit Aleks Komneni, pasi që Normanët e bashkuar t'i afroreshin Durrësit dhe do ta rrethojnë.<sup>436</sup>

Burimet historike flasin se edhe Aleks Komneni, kur e pa se e kishte punën pisk luajti me “kartën katolike”, me ftesën për ndihmë drejtuar venedikasve, të

<sup>435</sup> Neuman, C “*Die Weltstellung des byzantinischen Reiches vor des Kreuzzügen*”, Leipzig 1894.

<sup>436</sup> Shih: Erdan, C: “*Die Entstehung des Kreuzzgedankens*”, 1935.

cilëve u premtoi ngulime në bregdetin shqiptar. Mirëpo kjo nuk i ndihmoi që ta mbrojtë Durrësin nga pushtimi norman. Pas disa fitoreve taktike, Komneni, në tetor të vitit të vijues, pësoi humbje nga Normanët dhe, bashkë me Gjergj Paleologun iku në Ohër. Pas kësaj fitoreje Guiskardi popullatës vendore ia drejtoi një mesazh me kërkesën t'i bashkohej, sepse “e priste liria që u mungonte.”<sup>437</sup>

Kryeushtaraku norman premtonte se kishte për qëllim që edhe principatat ortodokse të Bizantit t'i kthente nën drejtimin e Vatikanit, me çka paralajmëroheshin kthesa të mëdha, me anën e të cilave botës së krishterë u hiqeshin përçarjet e brendshme të cilat kishin arritur shkallën e armiqësive prej të cilave, në Lindje tashmë përfitonin Arabët dhe në përgjithësi Osmanët, që gjithnjë e më shumë Perandorisë lindore po ia shkurtonin krahët dhe kjo madje shpesh bëhej edhe me dëshirën e feudeve vendore të krishtera në Lindje, të cilat i kishte katandisur lufta ndërkishtare si dhe shthurja e brendshme e Bizantit.

Pasi që Durrësi, në tetor të atij viti, kishte rënë në duart e tij, Guiskardi kishte hapur rrugën për në Kostandinopojë. Ushtritë normane depërtuan në thellësi të territorit perandorak, përshkuan Epirin, Maqedoninë e Thesalinë dhe në fund rrethuan Larisën. Por në pranverë të vitit 1082, Robert Gusikardi u detyrua të kthehej në Itali, ku kishte plasur një revoltë e nxitur nga përkrahësit e perandorit bizantin, Aleks Komneni dhe ia kaloi komandën të birit, Boemundit.<sup>438</sup>

Largimi i Guiskardit në Itali krijoi një gjendje çliruese për Bizantin, pasi që i dha mundësi që në një rën anë të ndalonte depërtimet e forcave normane në Epir, Maqedoni dhe Adriatik, ndërsa në tjetrën i krijoi kushte që të lidhte një marrëveshje me Venedikun kundër Normanëve, dhe ia dolën të rikthejnë Durrësin nga Normanët. Edhe përkundër aleancës me Venedikun, fatet e luftës sigurisht se nuk do t'i buzëqeshin Aleks Komnenit siç i buzëqeshën, po qe se Gusikardi, pasi që të kishte shtypur revoltën në Itali të nxitur nga Bizanti dhe Venediku, sapo të kthehej në Vlorë, në vitin 1085, prej nga pastaj me mjaft sukses do të rinisë veprimet kundër ushtrive bizantine, të mos binte viktimë e një epidemie.

Vdekja e Guiskardit pati ndikim të dyfishtë: në frontin me Bizantinët, por edhe në rikthimin e trazirave në Itali, të cilat Bizantin për pak kohë e çliruan nga rreziku norman, të cilët sërish do të shfaqen, por tash edhe me ndihmën e kryqtarëve.<sup>439</sup>

---

<sup>437</sup> Shih: Regel, W: “*Fontes serum byzantinorum*”, I, 1892.

<sup>438</sup> Ostrogorski, Georg: “*Historia e Perandorisë Bizantine*”, Tiranë 2002, faqe 255.

<sup>439</sup> Shih: Gregorie, H “*La Chanson de Roland de l'on 1085*”, 1939



Ndërkohë, aleanca e lidhur me Venedikun, Bizantit do t'i kushtojë shumë. Sepse, Venediku kërkoi çmim të lartë për ndihmën që dha për t'ia kthyer Durrësin Bizantit. Me anën e një traktati të majit të vitit 1082 dogji i Venedikut mori për vete e për pasardhësit e tij titullin *protosebaste*, me një honorar vjetor të mirë, kurse patriku i Grados u nderua me titullin *hypertimos*, ndërsa kisha e Venedikut me një kontribut vjetor prej njëzet libra ari. Por, përfitimet më të mëdha nga kjo marrëveshje Venediku do t'i sigurojë në fushën e tregtisë, meqë tash e këndeje tregtarët e saj do të lejoheshin të tregtonin lirshëm në të gjitha viset e Perandorisë Bizantine, përfshirë vetë Kostandinopojën, pa paguar asnjë taksë doganore. Kështu, venedikasit privilegjoheshin kundrejt tregtarëve vendas. Në këtë mënyrë Venediku hidhte themelet e fuqisë së vet koloniale në Lindje dhe në të njëjtën kohë u hap një e çarë e thellë në sistemin tregtar të shtetit bizantin. Fakti që Venediku vazhdoi të njohë të drejtat e sovranitetit të perandorit bizantin nuk ndryshoi asgjë. Republika detare italiane do të jetë një faktor përcaktues në historinë e Bizantit.<sup>440</sup>

Në kohën kur Aleks Komneni “bleu” sigurinë e përkohshme nga Normanët prej Venedikut me një çmim të lartë, në të njëjtën kohë, do të ballafaqohet me Peçengë, një popull lindor turkmen, tepër luftarak, kryesisht të besimit bogumil, të cilët prej vitesh po e kërcënonin Bizantin dhe së fundit kishin gjetur përkrahjen e bogumilëve në pjesën lindore të Gadishullit Ilirik, që këtë ta bënë në një kohë kur Perandoria po përballej me rrezikun norman në Adriatik, ku edhe kishte filluar t'i thyhej “gardi”. Pas luftërash të ashpra me ta, ku Bizantinët tregohen të paftë që t'i pengojnë, Peçengët ia dolën që t'u afrohen mureve të Kostandinopojës. Rreziku do të shtohet edhe më kur atyre do t'u bashkohen edhe trupat e emirit të Smirnës Çaha, njëri ndër emirët trashëgimtar të Sulajmanit, që kishte vdekur më 1085, që kishte lidhur aleancë me Peçengët për ta pushtuar kështjellën bizantine.<sup>441</sup>

Por, Komneni dinak, edhe këtë rrezik ia doli ta përballojë duke futur në lojë kartën e “armikut të armikut”, siç kishte bërë në Durrës kur në luftë me Normanët thirri në ndihmë venedikasit, edhe kundër Peçengëve thirri në ndihmë Kumanët, një tjetër popull nomad, turk nga gjuha por jo të tillë për nga origjina etnike. Ata erdhën me të shpejtë në territorin bizantin, ku nga perandori iu prem-tua qëndrim dhe prona të mira me kusht që të hiqnin dorë nga plaçkitjet që kishin bërë deri atëherë. Në prill të vitit 1091, rrëzë malit Levunion, Kumanët zhvilluan

<sup>440</sup> Jireček, K: „*Die Bedeutung von Ragusa in der HandelsGeschichte des Mittelalters*”, 1899, faqe 9.

<sup>441</sup> Ostrogorski, Georg: “*Historia e Perandorisë Bizantine*”, Tiranë 2002, faqe 257.

betejën përfundimtare kundër Peçenëve, që jo vetëm e fituan, por masakruan Peçenët deri tek i fundit. Këtë masakër me fjalë tepër tronditëse e përshkruan edhe e bija e perandorit, Ana Komneni, e cila thotë: “një popull i tërë, që llogaritej me dhjetëra mijëra njerëz, u shua në një ditë të vetme”.<sup>442</sup>

Në këtë udhë, pra me një të rënë dy të vrarë, perandori bizantin ia doli të qërojë hesapet edhe me Çahen e Smirnës kundër të cilit do të nxisë dhëndrin e tij, emirin e Nikesë, Abul Qazim. Ndërsa këtë të fundit do ta nxisë kundër disa emirëve të tjerë të cilët do t'i fusë në luftë kundër sulltanit të ar-Rumit, i cili nga luftërat e brendshme midis emirëve që drejtoheshin nga Bizanti, do të shpërbëhet, gjë që krijonte mundësi të mira që Komneni të ripushtonte Azinë e Vogël.<sup>443</sup>

Rruga për t'i rikthyer zotimet në Azi të Vogël, Aleks Komnenit do t'i pritët pikërisht nga Perëndimi, ku ai kishte menduar se me marrëveshjen me Venedikun ia kishte dalë që të largojë njëherë e mirë rrezikun norman, pasi që ata të jenë larguar nga Durrësi dhe në përgjithësi nga ana tjetër e Adriatikut, ku në rrugë e sipër për në Kostandinopojë, kishin zënkuar dhe për katër vite me radhë kishin mbetur të ngjuar në midis Epirit, Maqedonisë dhe Trakisë. Ishin kryqtarët që tashmë, pas thirrjes së papës Urban II në Koncilin e Klermonoit për të çliruar varrin e shenjtë, i cili nga viti 1077 ndodhej i pushtuar nga Turqit Selxhukë, të cilët kishin pushtuar Jerusalemin. Papatë atë kohë ishte forcuar dhe te ideja e kryqëzatës shihte mundësinë e mirë për të shtrirë pushtetin sa më thellë në Lindje. Thirrja e papës gjeti jehonë të madhe tek zotërinjtë feudalë të etur për toka e për aventura si dhe tek masat e Perëndimit, të rrënuara nga vështirësitë ekonomike dhe të përfshira nga entuziazmi fetar. Kjo thirrje, gjeti përkrahje edhe në Lindje, meqë Toka e Shenjtë kishte qenë dikur krahinë bizantine, e cila duhej çliruar, dhe se kjo paraqiste një detyrim shtetëror dhe jo si një detyrim i krishterimit në përgjithësi. Përparësia e detyrimit shtetëror ndaj atij të krishterë, kishte të bënte me skizmën midis dy kishave, që pamundësonte çfarëdo bashkëpunimi me Perëndimin.

Ka shumë burime kishtare apo diplomatike të kohës që flasin se do të ketë qenë Aleks Komneni, që me anën e emisarëve të vet, por edhe drejtpërdrejt të ketë kërkuar nga Papa Urban II që kryqtarët të drejtoheshin sa më shpejt në “misionin e tyre të shenjtë”<sup>444</sup> meqë ashtu mund të mobilizonte luftën e tij kundër

---

<sup>442</sup> Gyboni, M: “*Le nom de Βλαχη dans l’Alexiade d’Anne Comnene*”, 1951, faqe 44 dhe Ostrogorski, Georg: “*Historia e Perandorisë Bizantine*”, Tiranë 2002, faqe 257.

<sup>443</sup> Shih: Laurent, J: “*Byzance et les origines de Sultanat Raoum, Melanges Diehl*”, I, 1930.

<sup>444</sup> Më gjerësisht shih: Holzman, W: “*Studien zur Orientpolitik des Reformpapsttums und zur Entstehungen des ersten Kreuzzuges*” (Hist. Vierteljahrscht, 22 (1942), 167 si dhe “*Die Unionsverhandlungen zwischen Kaiser Alexios I und Papst Urban II. Im Jahr 1089*”, 1928, faqe 38. Vlerësimi se perandori Aleks Komneni

Lindjes, ku kryqtarët dhe fanatizmi i tyre do të shfrytëzoheshin për këto qëllime. Por, si do të shihet, ky hesap do t'i nxjerrë telashe Komnenit dhe vetë Perandorisë, që do t'i kthehet në një fitil të mëtejshëm të Bizantit dhe krishterimit në përgjithësi.

Se do të jetë kështu, këtë e tregoi edhe “pararoja” e kryqtarëve, që erdhi nga eremiti i Amienit. Bëhet e ditur se atë e ndiqte një turmë fanatikësh të shthurur, të cilët, në rrugë e sipër, duke kaluar nëpër Hungari dhe viset e Ilirikut, iu dhanë pas plaçkës. Me atë hov, më 1 gusht ata arritën në Kostandinopojë, ku vazhduan plaçkitjet, por perandori i cili kishte hesapet me ta dhe me të tillët, urdhëroi që të përcilleshin prej Bosforit për në Azi të Vogël, ku u shpartalluan keqas nga Turqit dhe vetëm një pjesë e vogël e tyre ia doli të kthehet në Kostandinopojë.<sup>445</sup>

Shpartallimi i pararojës së kryqtarëve, megjithatë nuk ndali planet për fillimin e tyre të organizuar, meqë të gjithë ishin të interesuar për to, pavarësisht prej asaj që secila palë priste. Kështu që nga fillimi i vitit 1096 në kryeqytetin e Bizantit zbret ajka e kalorësisë perëndimore, ajo që më së shumti priste prej kësaj ndërmarrje. Midis tyre ishte duka i Lorenës – Gotfrid i Buljonit, konti Rajmond i Tuluzës, Hugo de Vermandua, vëlla i mbretit të Francës, Roberti i Flandrës. Aty gjendet edhe princi norman Boemund, djali i Rober Guiskardit, i cili para dhjetë vitesh kishte udhëhequr fushatën e parë normane në Epir, Maqedoni e Thesali, dhe ai madje përkohësisht ia kishte dalë të merrte edhe Durrësin, që u detyrua ta lëshojë pasi që të jetë sulmuar nga venedikasit.<sup>446</sup>

Në këto rrethana jo gjithaq të natyrshme për Bizantin, ku kishte kohë që Kostandinopoja kishte harruar praninë e fisnikëve dhe kontëve perëndimorë, sërisht doli në pah dinakëria e Aleks Komnenit, i cili kishte nevojë për kryqtarët dhe po ashtu kishte frikë për fuqinë e tyre që do ta fitonin, do të hartojë një marrëveshje me anën e së cilës, mundësohej që mishi të piqej e helli të mos digjej. Pra, nga e gjithë kjo doli një marrëveshje sipas të cilës Bizanti atyre u njihte të drejtën e pronave, por me kusht që ato t'i riktheheshin Perandorisë dhe ajo pastaj, me anën e një dekreti, t'ua njihte të drejtën e pronës dhe drejtimit të tyre në përputhje

---

kishte kërkuar ndihmë nga Papa Urban II, vërtetohet edhe nga burime bizantine, veçmas ato që vinë nga Synopsis Sathas (Teodor Skutarioti), i cili pranohet edhe nga historiani me renome P. Lemerle *“Byzance es la Croisade, Relazione del X Congresso internazionale di scienze storiche”*, Romë 1955, III, 600. Sipas këtij historiani thelbi i problemit nuk qëndron në të mësuarit e të vërtetës nëse Aleks I i bëri apo jo kërkesë për ndihmë Perëndimit, sepse nuk diskutohet që ai i ka bërë, bile disa herë, një kërkesë të tillë. Por, problemi qëndron në faktin se ç'qëllime kishte kërkesa e tij për ndihmë: kërkonte trupa në ndihmë të Perandorisë së tij apo donte të organizonte një kryqëzatë perëndimore?

<sup>445</sup> Më gjerësisht: Neumann, C: *“Die Weltstellung des byzantinischen Reiches vor den Kreuzzügen”*, Lipsia 1894.

<sup>446</sup> Ostrogorski, Georg: *“Historia e Perandorisë Bizantine”*, Tiranë 2002, faqe 258.

me ligjet perandorake. Me anën e këtij kompromisi perandori merrte përsipër furnizimin e kryqtarëve me ushqime dhe pajisje ushtarake. Perandori, po ashtu u zotua, se edhe vetë do të rrëmbente kryqin dhe me të do të vihej në ballë të kryqtarëve me gjithë ushtrinë e tij. Mbi këto kushte u nënshkrua marrëveshje me princat e veçantë, e cila u nënshkrua edhe nga Boemundi, nipi i Guiscardit, që si do të shihet, pas pak atë do ta thyejë, por të cilën nuk e nënshkroi vetëm Rajmondi i Tuluzës.<sup>447</sup>

Me moton e kësaj thirrjeje, në pranverën e vitit 1097 filloi edhe kryqëzata e parë. I biri i Guiskardit, Boemundi, pasi që në ndërkohë edhe një herë tjetër me ushtritë e tij kaloi nëpër vendet e Arbrit dhe popullata ende nuk e kishte marrë veten nga dëmet që kishin pësuar nga Normanët, sërish shfaqet me qëndrimin se “*vendet e Arbrit kishin nderin që kryqtarët e mbledhur nga të gjitha vendet evropiane, prej andej niseshin për në Jerusalem për ta rikthyer varrin e shenjtë dhe tokat e shenjta krishtere që ndodheshin nën pushtimin e Turqve Selxhukë*”.<sup>448</sup>

Krahas kryqtarëve të shumtë normanë që prapë zbarkuan në Vlorë e Himarë dhe ndoqën rrugën gjatë Vjosës dhe Devollit, ata erdhën edhe nga dy drejtime të tjera. Kryqtarët e Provansës (Franca e Jugut), të prirë nga konti Rajmond i Tuluzës, nëpër Dalmaci, hynë në vendet e Arbrit nga ana e Shkodrës. Kryqtarët frëngj të Flandrës e të Normandisë, duke kaluar nëpër Itali, u hodhën në Durrës nga deti. Të dy këto grupe e përshkuan vendin duke ndjekur, gjatë luginës së Shkumbinit, rrugën mbretërore Egnatia.<sup>449</sup>

Suksesi i parë i rëndësishëm i kryqëzatës që pushtimi i Nikesë, në qershor 1097. Me këtë rast kryqtarët mbajtën fjalën, meqë qytetin që e morën me gjak ia dorëzuan perandorit Aleks Komneni, ku me të shpejtë u vendos një garnizon perandorak. Kryqtarët, me ndonjë përjashtim të vogël, siç ishte ai i Balduinit, vëlla i Gotfridit të Bulonit dhe Tankredit, nip i Boemundit, kishin bërë njëshmangie në Kiliki, për të marrë për vete qytetet e atjeshme, prej nga Balduini do të vazhdojë marshimin e tij në viset veriore të Mesopotamisë, kur formoi një principatë autonome me qendër në Edesë.<sup>450</sup>

Në të vërtetë, këtu do të dalin në pah në njërën anë mosmarrëveshjet e kryqtarëve me Aleksin I, dhe në tjetrën anë ato midis kryqtarëve si duhej vepruar në rrethanat e reja kur ata me çlirimet e viseve të pushtuara kishin shkuar

<sup>447</sup> Shih: Guillard, R: “*Le grand domesticat a Byzance*”, 1938.

<sup>448</sup> “*The Oxford Dictionary of Byzantium*”, vol. I-III, New Jork – London, 1991 dhe Schreiner, P: “*Die Byzantinischen Kleinchroniken*”, I, Wien, 1975.

<sup>449</sup> Shih: Scharanis, P: “*Byzantium, the West, and the Origin of the First Crusade*”, në BYZ. 19/1949.

<sup>450</sup> Ostrogorski, Georg: “*Historia e Perandorisë Bizantine*”, Tiranë 2002, faqe 253.

tutjemarrëveshjes që kishin me Aleksin I. Shkas ishte pushtimi i Antiokesë, kryeqendrës së Sirisë, ku më 3 qershor 1098 kishin hyrë kryqtarët. Në këtë matje për ta fituar Antiokenë, më i shkathëti ishte treguar Normani Boemund, i cili ashtu përmbushte amanetin e Gusikardit që e kishte lënë sapo kishte zbritur në Vlorë, në vitin 1081, kur ishte betuar se në Lindje do ta themelonte Romën normane.

Pas tre muajsh armata e kryqtarëve kaloi Bosforin dhe u hodh në pjesën e Azisë së Vogël prej nga një pjesë e tyre do të jepen pas pushtimeve të shumta ku do të mbesin përgjithmonë, ndërsa pjesa më e madhe iu afrua Jerusalemit dhe për më shumë se dy vjet do ta mbajnë të rrethuar. Atëbotë Jerusalemi ndodhej nën sundimin e kalifit Fatim të Egjiptit dhe bënte përpjekje të mëdha që t'u bënte ballë kryqtarëve. Por, më 14 korrik të vitit 1099 Jerusalemi ra në duart e tyre. Shënohet se me atë rast ata bënë masakra të tmerrshme ndaj popullatës arabe, e cila u shfaros thuajse në tërësi. Kjo masakër do të hapë hendekun e përhershëm të gjakut midis Frankëve dhe Turqve e Arabëve në tjetrën anë. Me këtë rast kryqtarët shpallën “*Mbretërinë latine të Jerusalemit*” nën drejtimin e dukës Lorenës, Godefroy de Bouillon, i cili mori titullin “*Mbrojtës i varrit të shenjtë*” për të sunduar Palestinën si mëkëmbës i Papës. Pas vdekjes së Bouillon-it pas një viti, vendin ia zuri i vëllai, Baldwin, i cili ia hapi rrugën njëqindvjeçare “*Mbretërisë latine të Jerusalemit*”, e cila përfshiu Palestinën dhe disa pjesë të tjera të Lindjes. Krahas krijimit të “*Mbretërisë latine të Jerusalemit*”, një sukses tjetër i kryqëzatës së parë, së paku në ruajtjen e ndikimit të perëndimorëve në këtë pjesë të botës, shfaqej principata e Antiokisë, sundimtar i së cilës u bë duka i Normanëve, Boemundi, i cili në rrethanat e reja, asnjëherë nuk hoqi dorë nga ambiciet për pushtimin e Kostandinopojës dhe të rrënimin të Bizantit në përputhje me atë që dikur kishte kërkuar edhe mbreti Rozher.<sup>451</sup>

Në këto rrethana, perandori AleksKomneni, mund të toleronte “*Mbretërinë Latine të Jerusalemit*” në Palestinë nën drejtimin e dukës Boillon, por jo edhe me vendosjen e Boemundit në Antiokë, sepse principata normane në Siri shfaqte një kërcënim të drejtpërdrejtë për interesat e saj në pjesën më të rëndësishme. Principata normane në Siri shihej me sy të keq edhe nga Turqit, të cilët tashmë kishin një marrëveshje me Aleksin. Kështu princi norman u gjend njëherësh në shënjestër të dy kundërshtarëve të fortë: Bizantinëve dhe Turqve. Pas një lufte gati dyvjeçare ai u zu rob nga emiri Malik Gazi i dinastisë Danishmendi, por u lirua me pagesë nga kryqtarët dhe u kthye në Antiokë. Por, pas një humbje të rëndë në

---

<sup>451</sup> Neumann, C: “*Die Weltstellung des byzantinischen Reiches vor den Kreuzzügen*”, Lipsia 1894.

vitin 1104, që Latinët pësojnë nga Turqit pranë Harranit, ai la Tarkendin në Antiokë dhe u kthye në Perëndim për të përgatitur një fushatë të gjerë kundër Bizantit.

Normanët, të udhëhequr nga konti Boemund, që kishte me vete një ushtri prej 250 mijë vetash, dhe me bekimin e Papës Grigorit, në pranverën e viti 1107, luftën kundër Bizantit, do ta bëjnë me pushtimin e bregdetit të Adriatikut në Ilirik. Boemundi nga Apullia zbriti në Vlorë prej nga flota bizantine nuk ishte në gjendje që t'ia ndërpriste depërtimin. Pastaj Normanët iu drejtuan Durrësit, të cilin e rrethuan dhe e morën në saje të popullatës vendore e cila iu bashkua. Ngjashëm u vepruar edhe me rastin e sulmeve dhe marrjes së Krujës dhe Dibrës, kur ushtria bizantine e udhëhequr nga komandanti Kantakuzeni pësoi disfata të thella, të cilat u përsëritën edhe me rastin e marrjes së Kaninës dhe të fortesave përgjatë luginës së lumit Erzen.

Normanëve nuk u priu fati që nga Iliriku bregdetar dhe ai Qendror (Epiri, Dardania dhe Maqedonia) ta rrënojnë fortesën e Bizantit dhe atje ta promovojnë Perandorinë e Romës. Nuk qe fuqia ushtarake e Bizantit, që në luftë me Normanët kishte humbur pjesën më të madhe të fortesave të saj ushtarake në Ilirik që pengoi Normanët të realizojnë qëllime historike, por ishte sëmundja e kolerës, që atë dimër përfshiu taborët Normanëve. Kolera i përgjysmoi dhe molisi fare normanët, sa që konti Boemund, si princ i Antiokies, nuk kishte rrugëdalje tjetër, pos që pa luftë, të pranojë të shpallet vasal i perandorit të Bizantit. Në Itali kthehet me ushtarët që i kishin shpëtuar kolerës dhe sapo të arrijë atje deklaroi se prapë do t'i kthehet Ilirikut për ta rrënuar Bizantin. Kjo nuk do të ndodhë, sepse vdiq në verën e vitit 1111.

Ndonëse kohë pas kohe, kryqëzatat do të vazhdojnë dhe, nga e dyta e këndeje, do t'i anashkalojnë vendet e Arbrit në Ilirik, ato nuk do të jenë në gjendje të ngjallin shpresën për rikthimin e asaj që quhej mbizotërim i Perandorisë Perëndimore me Romën si udhëheqëse në gjithë hapësirat nga shtriheshin vendet e krishtera, të cilat, si do të shihet, më shumë do të kenë telashe me vetveten se me rrezikun osman që e kishin pranë dhe pas pak edhe pjesa lindore do t'i kthehet në kob. Normanët, që fillimisht paraqiteshin si fuqi lëvizëse e tyre dhe mbase edhe do të kishin sukses që mbretërive dhe principatave të lodhura katolike t'ua kthenin shkëlqimin e dikurshëm, gjykohen të dështojnë, nga vetë hezitimi, po edhe frika e perëndimorëve, nga ky sukses! Burimet e shumta bëjnë të ditur se edhe vetë Vatikani, frymëzuesi kryesor i kryqëzatave dhe përkrahësi i Normanëve drejt pushtimeve kah Lindja, çastin që pa se Normanët, megjithatë, gjendeshin

afër kthesës historike, filloi intrigat e njohura drejt sabotimit të suksesit të tyre. Si zakonisht, ato filluan nga mbështetësit kryesorë të tij: Venediku dhe Gjenova, të cilët do të përfshihen në lojëra të ndryshme, që Normanëve do t'u kthehen në telashe dhe disfata madje pa qenë të vetëdijshëm se u vinin nga bekuesi i tyre kryesor, Papati.<sup>452</sup>

Sigurisht se kjo prapaskenë e Vatikanit, kishte të bënte edhe me hesapin se edhe përkundër kundërshtimeve dhe mospajtimeve të njohura me Kostandinopojën, ajo duhej ruajtur nga rrënimi përfundimtar.

Kjo strategji madje do të shihet më së miri edhe nga qëndrimi i Papës, Bonieka III kur gjithë dëshpërim, gjatë Kryqëzatës së Katërt, me një qortim, do t'i drejtohej markezit të Monteferratos rreth atyre që kishin ndodhur në kryeqytetin e Bizantit pas hyrjes së kryqtarëve në të:

*"Ju shëmtuat qëllimin e shenjtë për të cilin ishit nisur, duke luftuar kundër kristianëve në vend të saracenëve, duke zaptuar Kostandinopojën në vend të Jerusalemit, duke preferuar begati materiale të kësaj bote në vend të lumturisë hyjnore në botën tjetër".<sup>453</sup>*

Një pjesë e strategëve të papatit ishin të mendimit se Bizanti, duhej përkrahur që t'u bënte ballë pushtimeve osmane dhe rreziqeve në shtim që krishterimit i vinin nga Lindja dhe Perëndimi prandaj nuk kishte interes që ta rrënojë digën e natyrshme mbrojtëse kundër tyre. Por, si do të shihet, pas dobësimit të Normanëve, do të jenë venedikasit, të cilët do të bëjnë çmos që Bizantit t'i merrej push-teti nga brenda, në mënyrë që ai të kthehej në një marionetë të republikës tregtare të Adriatikut, e njohur për rolin e saj në këtë drejtim.

Strategjia që Bizantit t'i dobësohej pushteti, qoftë edhe me rrënimin e tij të drejtpërdrejtë, filloi qysh me Kryqëzatën e Dytë, kur pas rënies së Jerusalemit në duar të Saracenëve, në tetor të vitit 1187, që udhëhiqeshin nga princi Salahudin, thirrjen e Papës, Klementit III, për kryqëzatë të përgjithshme, në të cilën do të përfshihej perandori gjerman, Fridrih Barbarosa, venedikasit do ta inspirojnë që rruga për në Palestinë të kalonte nëpër Kostandinopojë dhe atje, para se të qëroheshin hesapet me saracenët, të vihej "rregull", ani pse Papati do të jetë kundër kësaj ecurie. Mbytja tragjike e Barbarosës, në rrugë për në Azi, dhe marrja e drejtimit të kryqëzatës nga Henriku IV, e kurseu për pak kryeqytetin e Bizantit nga

---

<sup>452</sup> Shih Ostrogorski, Georgie: "Istoria Vizantije", Beograd, 1969. Autori sjell dëshmi të shumta të marrëveshjeve të fshehta midis Vatikanit dhe Kostandinopojës për t'i penguar Normanët që të arrijnë sukseset e synuara ushtarake rreth rikthimit të Jerusalemit.

<sup>453</sup> Zavalani, Tajar: "Historia e Shqipnis", 1998, faqe 106.

ndëshkimi katolik, por jo përgjithmonë, sepse pas dështimit të Kryqëzatës së Dytë dhe të tretë, do të jetë Papa Inocenti III, i cili do të parashohë që kryqëzata e katërt të kalojë nëpër rrugë detare, pra që kryqtarët të zbarkonin në Egjipt, dhe prej andej t'i drejtoheshin Palestinës, meqë vlerësohej se kjo ishte rrugë më e lehtë. Papa, i cili pas shpërbërjes së Perandorisë së Perëndimit, kishte mbetur autoriteti i vetëm në këtë pjesë, i cili ndërmjetësonte midis mbetjeve latine dhe fuqisë gjermane të Henerikut, që pretendonte fronin e Bizantit, do të vërë në plan të parë politikën lindore, ku sipas tij Bizanti nuk duhej përmbysur me forcën e armëve, por duhej t'i nënshtrohej Selisë së Shën Petrit nëpërmes bashkimit të kishave dhe të merrte pjesë në kryqëzata së bashku me krishterimin perëndimor.

Arsyet pse papa tashmë luante me kartën e ruajtjes së Bizantit, ishin edhe të natyrës thjeshtë kishtarë, sepse ia kishte dalë që në pjesën e dikurshme të Ilirikut, të bënte për vete principatat rasiene dhe mbretërinë bullgare në rikthim e sipër, të cilat pas dobësimit të Bizantit, kishin filluar t'i kthenin sytë kah Selia e Shenjtë dhe të kërkonin përkujdesjen e saj shpirtërore, që nuk do të thoshte tjetër pos kthim kah Perëndimi. Kështu, dera e Nemanjave, e cila ishte shtrirë nga Duklea në Rashë, pasi të jetë pushtuar nga Bizanti dhe atje dhëndri i perandorit të Bizantit, Stefani, me titullin *sebastokratit*, do ta heqë të atin Nemanja, i cili do të bëhet murg dhe do të mbyllet në manastirin në Malin Atos, në vend se të lidhej me Bizantin, do t'ia kthejë shpinën vjehrrit për t'u lidhur me Romën.<sup>454</sup>

Pse Stefani nuk do t'ia dalë kësaj gjatë përpjekjes së parë, fajin e kishte i vëllai, Vukani, i cili kishte mbetur në Diokle (Zetë). Vëllezërit Stefan dhe Vukan, njëri zot i Rashës e tjetri i Dioklesë (Zetës) do të hyjnë në luftë për pushtet me njëri-tjetrin dhe secili do të mundohet të përfitojë si aleat Hungarinë dhe papatin. Në këtë luftë të përgjakshme Vukanit i erdhi në ndihmë Hungaria dhe pasi njohu pushtetin e papës dhe sovranitetin hungarez, në vitin 1202 hipi në pushtet, të cilin do ta humbë pas pak nga që i vëllai Stefani, atë e riktheu me ndihmën e Bullgarëve.<sup>455</sup>

Por, kjo nuk do të thoshte se ai kishte hequr dorë nga Roma dhe tutela e saj në të cilën ishin futur rasienët. Përkundrazi, ishin vetë Bullgarët që kishin pranuar kishën romane, si “garant” të kësaj loje midis vëllezërve. Selia e Shenjtë kulaçit

---

<sup>454</sup> Më gjerësisht shih: Miklosich, F: „*Monumenta Serbica spectantia historiam Serbiae, Bosnae, Rsgusii*”, Wien 1858; Jiriček, C: “*Staat und Gesellschaft in mittelalterlichen Serbien*”, III, Denkschriften, Wiener Akademi, 1914; “*Zbornik Ilariona Ruvaraca*”, Beograd, 1934; Stojanović. I “*Istorija srpskog naroda*”, Beograd 1926; Ђирковић, Ц: „*Српски летописи и византијске кратке хронике*“, Деспотовац, 1998: „*Istorija naroda Jugoslavie*“, Beograd 1953.

<sup>455</sup> Shih Gelcich, Guiseppe: “*Zeta dhe dinastia e Balshajve*”, Tiranë 2009, faqe 18.



të Ilirikut me Bullgarët, ia shtonte edhe pjesën rasiene. Kështu Roma, në prag të rënies së Kostandinopojës kishte shtruar nën hegjemoninë e vet shpirtërore jo vetëm rasiënë tribalë, por edhe Bullgarët dhe e kishte shtrirë sferën e vet të ndikimit në pjesën më të madhe të Ilirikut. Ishte kjo një gjendje thuajse e përafërt me atë që kishte vendosur gjashtë shekuj më parë perandori Justinian I kur në Jusitniana Prima të Dardanisë, që ishte në përbërje të provincës së madhe të Ilirikut, atë e kishte vendosur nën juridiksionin e Selisë së Shenjtë, ku mbeti deri në Koncilin VIII të Kostandinopojës të vitit 870, kur viset e pushtuara të Ilirikut nga Bullgaria kaluan nën mbikëqyrje të plotë kishës lindore dhe me këtë merr fund edhe subjektiviteti administrativ dhe ai shpirtëror i Ilirikut në kuadër të Perandorisë.

Megjithatë, duhet thënë se gjendja që kishte krijuar Selia e Shenjtë në dobi të Perëndimit, ku tashmë rasiënë dhe Hungarezët ishin përfshirë nën kurorën e saj, shkonte në dëm të vendeve të Arbrit, meqë gjatë asaj kohe, një pjesë e mirë e Dardanisë dhe e Maqedonisë pushtohen nga zhupani tribal, Nemanja, me çka mund të thuhet se Rasha, kjo kështjellë e vogël, për herë të parë, shtriu pushtimet e veta në këto anë. Kësaj do t'i paraprijë forcimi i Bullgarisë, e cila zgjerohet në territoret e Bizantit, e me të cilën zhupani Nemanja kishte bërë aleancë me Petrin e Bullgarisë që bashkërisht të ndanin pjesët e Ilirikut të Bizantit.<sup>456</sup>

Kështu, ai pushtoi Nishin dhe shkatërroi luginën e Timotit, ku bëri dëmtime të mëdha.<sup>457</sup> Me këtë rast Nemanja rrënoi në tërësi qytetin antik, që kishte qenë ndër kryesorët në Dardani gjatë kohë së Justinianit. Që të siguronte këto pushtime Nemanja, i cili ishte në dijeni se kryqëzata e ardhshme drejt Jerusalemit do të nisej nga Gjermanët dhe ata bashkë me Hungarezët shfaqeshin si mbështetësit e saj kryesorë, nxitoi që në krishtlindjen e vitit 1188 të dërgojë përfaqësuesit e vet në oborrin perandorak në Nyrnberg, ku mbretit Fridrihi i dorëzohet shkresa sipas së cilës thuhej, “Rasiënë prisnin me gëzim shumë të madh kalimin e ushtrisë së kryqtarëve përmes vendit dhe nuk uronte asgjë më me dëshirë se sa ta përshëndeste personalisht perandorin”.<sup>458</sup>

Në pranverën e vitit 1189 ushtria e madhe kryqtare e udhëhequr nga Fridrihu nga Hungaria kaloi Danubin dhe luginës së Moravës arriti Nishin. Më 27 korrik përpara perandorit të madh u shfaqën Nemanja dhe i vëllai Strazimiri, të cilët i sollën dhurata të shumta dhe iu falënderuan që nga depërtimi i tyre iu mundësua

---

<sup>456</sup> Jiriček, Konstatindin: “*Historia e serbëve*”, Tiranë 2010, faqe 305.

<sup>457</sup> Po aty.

<sup>458</sup> Po aty, faqe 306.

që të nxirrnin shumë përftime (pushtimi i Nishit dhe pjesëve përreth, ku ata shfaqen herë të parë) dhe kërkuan të bëheshin vasalë të Gjermanëve, duke ia bërë me dije se ishin të gatshëm ta përkrahnin me të gjitha mjetet kundër Grekëve.<sup>459</sup>

Perandori Fridrih, që kishte mendjen të Jerusalemi, megjithatë, nuk pengoi që aleatët e tij (Rasianët dhe Bullgarët) depërtimin e tij drejt Lindjes ta shfrytëzonin edhe për qëllimet e tyre, siç ishin ato që ata të nxirrnin sa më shumë përftime në drejtim të Jugut, në Ilirikun Qendror, në Dardani dhe Maqedoni.

Në të vërtetë kështu edhe do të ndodhë. Një pjesë e mirë e ushtrisë së Stefan Nemanjës vazhdoi bashkë me kryqtarët që drejtonte Fridrihu në drejtim të Adrianopojës, por në të njëjtën kohë, Nemanja drejtoi një numër të mirë të trupave të tij luginës së Moravës dhe të Ibrit për të pushtuar Skupin dhe Prizrenin si dhe krahinat e Pollogut të Sipërm dhe të Poshtëm. Kështu në janar të vitit 1190 ushtria e Nemanjës shkatërroi kështjellat bizantine të Serdicës deri në Prizren, ku pushtoi edhe Skupin si dhe krahinat e Pollogut. Me këtë rast ai e vuri në lidhje vasale princin arbëror, Progonin, të cilit ia dha vajzën Komitën.<sup>460</sup>

Kjo pra do të jetë dalja e parë e Rashës tribale në Ilirikun Qendror (hapësirën e Dardanisë dhe Maqedonisë antike), që deri atëherë ishin pjesë e Bizantit dhe qeveriseshin nga fisnikët, despotët dhe princat vendorë. Ky fakt ka rëndësi të madhe, sepse heq mjegullimin e krijuar nga disa dokumente kishtarë të sajuara dhe të rishkruara në shekullin XIX, sipas të cilave prania shoqërore dhe politike rasine në këto pjesë, ndonëse e njohur si tribale, gjoja daton nga shekulli VII i erës sonë e këndeje, madje me atributin e “shtetit mesjetar serb”, që rëndom i atribuohet emërtimit “Rassia”, “Regni Rascia”, i njohur nga kronikat bizantine!

Edhe pse pas marrëveshjes së perandorit gjerman, Fridrih, me Bizantin në Adrianopojë (14 shkurt 1190), që kryqtarët nëpër Helispont të drejtohen për në Azi, me çka Rasianët dhe Bullgarët nuk mund të llogaritin më në ndihmën gjermane për të vazhduar pushtimet e tyre në pjesët qendrore të Bizantit, shumë prej të cilave tashmë i kishin pushtuar, zhupani i Rashës, Stefan Nemanja ia doli që edhe pas humbjes që pësoi nga perandori bizantin Isak në betejën e Moravës, të nënshkruajë një marrëveshje të favorshme paqësore me Bizantin e interesuar që plangëprishësit megjithatë t’i mbajë afër. Me anën e saj, Nemanja përligji pushtimet e viseve dardane, ku shtrihej qytetërimi i tyre nga antika e këndeje, i cili kishte gëzuar lulëzim të veçantë gjatë kohës së Justinianit I, kur ishte kthyer në qendër administrative dhe shpirtërore të tyre, ndër më të njohura e Ilirikut.

---

<sup>459</sup> Po aty, faqe 307.

<sup>460</sup> Po aty, faqe 328.

Kështu, mund të thuhet se pas këtyre pushtimeve të ndihmuara nga kryqtarët katolikë, Rasianët mbajtën një pjesë të rëndësishme të zonës së asaj që shfaqej si “*Bizant arbëror*” nga Nishi, Leskovci si dhe zonën e lumit Sitnica dhe të Llabit me Lipjanin. Në pellgun e Drinit të Bardhë mbajtën krahinat e pushtuara që i përkisnin Peshkopatës së Prizrenit, pastaj ato të Pejës dhe të Deçanit si dhe krahinat në veri deri në Shkodër. Nemanja u përforcua edhe në bregdet me pushtime të reja në pjesën e Dioklesë duke përfshirë edhe Tivarin dhe Kotorin.<sup>461</sup>

Arsyet pse Bizanti kërkonte që ta forconte zhupanin Stefan Nemanja me zotime të reja nga pjesa qendrore e deri në Adriatik (kryesisht me pjesë që u takonin vendeve të Arbrit) duhet kërkuar te përcaktimi që Rasha, duke pranuar vasalitetin e Kostandinopojës, të shfaqej si mbështetës kryesor midis Bullgarëve dhe Perëndimit, ku do të ruhej ngrehina e Bizantit, që tashmë tronditej nga brenda dhe nga jashtë dhe veçmas nga marrëveshjet e vazhdueshme që bënin vendet katolike të Perëndimit për t’i shfrytëzuar në luftë kundër Kostandinopojës. Për këtë arsye u lidh edhe një krushqi me Nemanjën. Djali i tij Stefani u martua me mbesën e perandorit Eudokia, të bijën e vëllai të tij Aleksit.<sup>462</sup>

Krahas përfitimeve të mëdha në pjesën qendrore dhe perëndimore, zhupani i Rashës u tregua i shkathët që të përforcohej në pjesën midis Dioklesë dhe të Zahlumisë, prej nga në të vërtetë shfaqen të dhëna jo gjithë meritore rreth organizimi shoqëror dhe politik i derës së tij nga shekulli IX e këndej, veçmas me ato që kanë të bëjnë me Rashën që qendër të fuqisë së tij të njëmendë, prej nga dihet se Stefan Nemanja iu kishte bashkuar kryqëzatës së Fridrihut I dhe ishte deklaruar se përkrahte fushatën e tij për në Jerusalem dhe madje pranonte vasalitetin gjerman, paçka se nuk do të vonojë për hyrë në marrëveshje të fshehta me Normanët për ç’gjë ishte angazhuar edhe Papa Klementi III (25 nëntor 1189) kur nga kryepeshkopët katolikë të Raguzës dhe Tivarit që ata të hynin në marrëdhënie miqësore me Nemanjën. Papa, madje, kishte kërkuar nga kryepeshkopi i sapoemëruar, Bernardi i Raguzës, që Raguzat të nderonte të bijtë e Nemanjës (*dilectis filiis, nobilibus viris megajupano, Straschimiro et Mirosclabo*),<sup>463</sup> që siç kishte kërkuar edhe i ati, ishte kthyer me besnikërinë ndaj kishës katolike.

---

<sup>461</sup> Po aty, faqe 310.

<sup>462</sup> Shih: Novaković, R: „*Kad se rodio i kad je počeo da vlada St. Nemanja*“, Në “Glasnik”,1958,3-4.

<sup>463</sup> Shih: Theiner: Mon. Slav. 1,6, (pa datë, përgjigje shkresës së Papës të 2 janarit 1199), cituar sipas Jiriček,K: “*Historia e serbëve*”, Tiranë 2010, faqe 311 dhe Ruvarac, Ilarion: “*Raški episkopi i mitropolit*“, Beograd 1934, faqe 12-16.

Në gjithë këtë zhvillim, që Selisë së Shenjtë në njëfarë mase ia kishte rikthyer hapësirën e ndikimit në pjesët e Ilirikut të dikurshëm, veçmas në pjesën e Dardanisë dhe të Maqedonisë, ku tashmë rasianët përpiqeshin t'i mbeteshin sa më të nënshtruar katolicizmit, Kisha Perëndimore, nuk ishte gjithaq e interesuar për rrënimin e baraspeshës kishtare pas ndarjes së saj në vitin 1054. Kishte frikë se kjo mund të dobësonte Bizantin, gjë që nuk ishte në interesin e saj, edhe pse si do të shihet, do të jenë pikërisht rasianët, “të përzgjedhurit” e Papatit, që do të përpiqen që me lojërat e kapërcimit “nga njëra anë në tjetrën”, të kthehen në faktor kyç të kësaj “baraspeshe”.

Kishte edhe një faktor tjetër në gjithë këtë shtjellim që kërkonte rrënimin e plotë të kësaj baraspeshe në dobi të katolicizmit, pra rrënimin e plotë të Bizantit dhe krijimin e Romës së re atje. Dogji plak i Venedikut, Henrik Dandali, i cili kishte në dorë përgatitjet e kryqëzatës, kishte krijuar bindjen se Bizanti duhej rënuar në themel. Ndonëse për rrethanat kjo dukej paksa e tepruar, meqë Venediku kishte kohë që ishte aleat i Bizantit dhe në saje të marrëveshjes me perandorin Aleks Komneni të vitit 1081, ia kishte dalë të pushtonte të gjitha tregjet e Perandorisë falë privilegjeve që gëzonte, megjithatë, pas vdekjes së Aleksit I dhe ardhjes në pushtet të trashëgimtarëve të tij, veçmas të Manuelit, Venediku i shihete në rrezik interesat e veta në Bizant. Ishin rivalët e tij Gjenova dhe Piza, tashmë të forcuar dhe me një marrëveshje të re me Manuelin që do të mundë ta hiqnin nga loja Venedikun. Andaj vlerësohej se ishte koha që i gjithë disponimi, por edhe mllëfi i Normanëve të shfrytëzohej për këtë qëllim.<sup>464</sup>

Mbi hesapet e Luigjit VII, Venediku mori përsipër drejtimin e kryqëzatës. Kryqtarët u grumbulluan në Venedik dhe meqë flota e këtij qyteti ishte e vetmja që mund ta bënte bartjen e mijëra vullnetarëve të krishterë për në Egjipt me flotën e vet, u desh një marrëveshje paraprake me dogjin Henrik Dandal, i cili nga kryqtarët kërkoi që shpenzimet e udhëtimit t'ia lanin Venedikut me anën e një ndërhyrje ushtarake për ta marrë Zarën, e cila mbahej nga Hungarezët. Kështu edhe u bë. Në nëntor 1202 Zara u pushtua. Kryqtarët në Zarë do të presin pranverën e vitit vijues. Aty do t'u bashkohet edhe djali i Isakut II. Aleks i ri kishte arritur të ikte nga burgu bashkë me të atin e tij të verbuar, ku ishte hedhur nga Aleks Engjëlli kohë më parë. Në maj të vitit 1203 në Korfuz u nënshkrua marrëveshja për devijimin e ekspeditës.<sup>465</sup>

---

<sup>464</sup> Shih: Neumann, C: “*Griechische Geschichtsschreiber und Geschichtsquellen*”, Lipsia 1888.

<sup>465</sup> Ostrogorski, Georg: “*Historia e Perandorisë Bizantine*”, Tiranë 2002, faqe 288.

Natyrisht se devijimi i ekspeditës që u bë në Korfuz ishte pjesë e lojërave të Venedikut me ç'rast ia doli që t'i bindë drejtuesit e kryqëzatës që të zbarkojnë në Kostandinopojë dhe atje t'i qërojnë hesapet me "komplotistët" bizantinë, të udhëhequr nga perandori Aleks III, që bashkëpunonte me Arabët dhe armiqtë e tjerë të katolikëve, gjë që kështu edhe do të ndodhë.

Kryqtarët nuk e patën të vështirë të futen në Bririn e Artë, pasi që thyen zinxhirin që pengonte hyrjen në gji. Prej andej kryqtarët filluan rrënimin e mureve të qytetit nga toka. Të kota qenë përpjekjet për t'u mbrojtur kryeqyteti i Bizantit. Më 17 korrik 1203 Kostandinopoja ra në duart e kryqtarëve. Perandori Aleks III iku bashkë me thesarin, ndërsa kryqtarët e kthyen në fronin perandorak të verbrin Isakun II, ndërsa i biri i tij, Aleks IV u emërua bashkëperandor.

Perandori i verbër nuk ishte në gjendje të mbajë gjatë fronin. Ngaqë të pakënaqur me të ishin si kryqtarët, të cilëve nuk ishte në gjendje t'ua paguante shpërblimin për të cilin ishte marrë vesh në Zarë sapo ata ta kthenin në fron, dhe po ashtu, me të ishin të pakënaqur Bizantinët, të cilët nuk mund ta duronin një perandor që mbikëqyrej nga Latinët dhe ishte në udhë e sipër që Perandorinë ta kthente në peng të tyre. Kjo bëri që në Kostandinopojë nga fillimi i janarit 1204 të shpërthejë një kryengritje që për pasojë pati rrëzimin e perandorit nga fronti, i cili humbi kurorën dhe jetën. Fronin e mori Aleks V, Duka Murzufli, dhëndër i Aleksit III e burrë i Evdoklisë, gruas së dikurshme të despotit Stefan, me çka në Bizant fitoi edhe një herë prirja antilatine, që u dha shkas kryqtarëve të derdhnin mllefën mbi kryeqytetin e Bizantit.

Kështu, kryqtarët, në verën e vitit 1204, në vend të Jerusalemit, iu vërsulen kryeqyteti i Bizantit. Gjatë asaj fushate, Kostandinopoja qe pre e rrëtimeve të papara të kryqtarëve, ku pësuan veprat e artit, por edhe vlerat e tjera që do të plaçkiten. Ndërsa drejtimi do t'i besohet Aleksit IV, një plaku të verbër, që u nxor nga burgu dhe u ul në një fron të paqëndrueshëm, të cilin do ta humbë pas pak, meqë kryqtarët do ta copëtojnë Perandorinë e Bizantit, të cilën e pagëzuan "*Perandori Latine të Kostandinopojës*" me perandor kontin Baldwin të Flandrisë.<sup>466</sup>

Me këtë ndërhyrje krijohen parakushtet për rrënimin e Bizantit, që para se të ndodhë në tërësi, ua hapi rrugën disa zhvillimeve shturëse gjithandej nga shtri-

---

<sup>466</sup> Më gjerësisht shih: Ostrogorski, Georg: "*Historia e Perandorisë Bizantine*", Tiranë 2002, faqe 301-303; "*Hitoria e Popullit Shqiptar*", I, Tiranë 2002, faqe 224-234; Jaques, Edwin: "*Shqiptarët*", Tiranë faqe 181-186; Zachariadou, e. A: "*Marginalia on the History of Epirus and Albama 1300-1418*", Wiener Zeitschrift für Kunde des Morgendlandes 78, 1988; Faverial, Zhan Klod: "*Historia e Shqipërisë*", Tiranë 2004, faqe179; Xhufi, Pëllumb: "*Nga Paleologët te Muzakajt*", Tiranë 2009, faqe 19-27; Zavalani, T: "*Histori e Shqipnis*", Tiranë.

hej, ku do të dalin në pah ambiciet e ndryshme të principatave të shumta për ta trashëguar atë ose për të përfituar nga rënia e tij, të cilat do të ndezin luftëra të shumta të brendshme, që si do të shihet do t'u shkojnë përshtati arabëve dhe turqve, të cilët pas një shekulli e gjysmë, Bizantin dhe sundimin e tij dhjetë-shekullor, e dërguan në vitrinat e historisë.

Koha prej më shumë se një shekulli, që do t'u mbesë gjithnjë e më e pakët mbrojtësve, shfrytëzuesve dhe rrënuesve të brendshëm dhe të jashtëm të Bizantit, që t'i japin fund ngrehinës së cilës prej kohësh po i pikonte çatia, kaloi nëpër shturje të ndryshme me konflikte, luftëra po edhe aleanca të shumtën të paqëndrueshme, ku edhe vendet e Arbrit dhe Arbrit do të përfshihen thuajse detyrimisht në të gjitha zhvillimet, të cilat janë të rëndësishme, sepse të ndërlidhura me to, shfaqen ato që paraqesin themele të shtetit të Arbrit në mesjetë si një vazhdim i natyrshëm prej ngrehinës së Perandorisë Bizantine në ngritjen e të cilit ata kishin marrë pjesë që nga fillimi kur bashkë me Latinët dhe Grekët e themeluan atë.

Të kësaj natyre janë “*Despotati i Epirit*” 1204-1253 dhe “*Mbretëria e Arbërisë*” 1272-1286. Njëri i themeluar nga Mihal Engjëlli i dytë<sup>467</sup>. Dhe tjetra e themeluar nga mbreti Karli i Parë Anzhu.<sup>468</sup>

“*Despotati i Epirit*” u shfaq në kuadër të përpjekjeve që trashëgimia e Bizantit të shfrytëzohet që të krijohej një strukturë shtetërore konkurruese me të tjerët dhe këtu duhet parë edhe përpjekjet e fundit të faktorëve autentik ndërtues të Bizantit - Arbërorëve për ta ruajtur atë përkundër gjasave gjithnjë e më të vogla që kjo të bëhej karshi rrezikut osman nga lindja dhe përpjekjeve të vazhdueshme të vendeve katolike nga Perëndimi.<sup>469</sup> Ndërsa “*Mbretëria e Arbërisë*” u shfaq, nga jashtë, në kuadër të strukturave shtetërore qoftë të përkohshme që perëndimorët kishin filluar t'i krijonin prej kurorave të tyre mbretërore në mënyrë që kështu të krijonin kushte që Bizanti në shprishje e sipër, nga brenda, të rikthehej në një perandori perëndimore.

Kjo e fundit, pra “*Mbretëria e Arbërisë*”, ndonëse do të ketë disa “përsëritje” dhe rikthime përpëlitëse thuajse për një shekulli, ku në disa faza do t'i mbesë vetëm “kurora” e jashtme, megjithatë për herë të parë promovon politikisht ekzistencën e “*Regnum Albaniae*”, në një raport domethënës të luftës së ashpër të Perëndimit kundër Lindjes, në të cilën Arbërorët shfaqen me mbretëri.

---

<sup>467</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*” I, Tiranë 2002, faqe 231-234.

<sup>468</sup> Po aty.

<sup>469</sup> Shih: Nicol, Donala M: “*The Despotat of Epiros*”, Oxford, 1957.

## “DESPOTATI I EPIRIT” DHE “MBRETËRIA E ARBËRISË”

Me të drejtë është thënë se rrallë herë në histori është ecur në mënyrë aq të planifikuar sa në rastin e ndarjes së Perandorisë Bizantine pas atyre që do të ndodhin gjatë Kryqëzatës së Katërt. Në të vërtetë e gjitha ishte pjesë e një hesapi midis kryqtarëve dhe dogjit të madh të Venedikut, Henrik Dandalit, i cili kishte luajtur rol vendimtar në ngjarjet e fundit, që po ashtu kishte luajtur rol vendimtar në ngjarjet e viteve të fundit dhe që kishte qenë edhe frymëzues i traktatit të ndarjes dhe, gjithashtu ishte bërë edhe protagonist i zbatimit të marrëveshjes.<sup>470</sup>

Hapi i pari i zbatimit të marrëveshjes së ndarjes së Perandorisë Bizantine ishte i natyrshëm të fillonte me zgjedhjen e një perandori në Kostandinopojë, akt ky që do të bëhet nën ndikimin e venedikasve, të cilët u përcaktuan për kontin Balduin të Flandresë, i cili më 16 maj në kishën e Shën Sofisë kurorëzohet perandor i Perandorisë Latine të Kostandinopojës. Atë e bekoj patriku i parë latin i Kostandinopojës, venedikasi Tomazo Morazini. Me këtë rast, si perandor i Perandorisë Latine, Balduini, mori një të katërtën e gjithë territorit të Perandorisë, ndërsa nga tri të katërtat që mbeteshin, gjysma u takonte venedikasve, kurse pjesa tjetër ndahej në feude perandorake që u shpërndareshin kalorësve. Por, përfitimet më të mëdha, si pritej, nga kjo ndarje i nxori Venediku. Edhe pse hoqi dorë nga territoret e Epirit, Akarnanisë, Etolisë dhe Peloponezit, mori portet e Koronës e të Modonit në Peloponez dhe pak më vonë edhe atë të Durrësit e të Raguzës në Adriatik. Republika e Adriatikut mori edhe ishujt e Jonit, Kretën, pjesën më të madhe të ishujve të arkipelagut, ndër të tjera Eubenë, Andron e Nakson, portat më të rëndësishme të Helespontit dhe të Detit Marmara: Galipolin, Rodostin dhe Heraklen si dhe Adrianopojën në brendësi të tokës së Perandorisë. Venediku, po ashtu mori edhe tre të tretat e qytetit të Kostandinopojës me çka u kthye në zot të çerekut të Perandorisë Bizantine. Kështu, Perandoria Bizantine u copëtua në një numër principatash të mëdha e të vogla, me një sistem të ndërlikuar e të larmi-shëm feudesh.

Themelimi i “*Despotatit të Epirit*” lidhet me Kryqëzatën e Katërt dhe pasojat e saj, që pati për Bizantin. Pasi që Latinët pushtuan Kostandinopojën dhe shpallën “*Perandorinë Latine të Kostandinopojës*”, Perandori Aleksi V u arratis dhe me thesarin që kishte me vete, u vendos në Nike (Nicean) në Azi të Vogël,

---

<sup>470</sup> Ostrogorski, Georg: “*Historia e Perandorisë Bizantine*”, Tiranë 2002, faqe 302.

ku edhe e shpalli kryeqytet. Meqë Aleksi V kishte humbur autoritetin, u desh që në skenë të dalë ushtaraku Theodor Laskaris, dhëndër i Komnenëve, i cili formoi “*Perandorinë në Mërgim*”. Në të u përfshinë kryesisht krahinat europiane të Bizantit, që nuk ishin pushtuar nga Latinët, apo që gëzonin njëfarë mëvetësie në përbërje të feudeve të caktuara. Në këtë përbërje përfshihen edhe disa feude nga Drini deri në gjirin e Korintit, që njiheshin si Epir. Mihal Engjëlli I, i cili ndodhej në Selanik shpallet Despot i Epirit, duke iu kundërvënë perandorit të Nikesë. Mihali nga Selaniku shkoi në Durrës, dhe atje, me ndihmën e ushtarëve arbëreshë dhe vllahë fortifikoi qytetin dhe ia doli që për dhjetë vjet me radhë të mbajë të fortë Despotatin e Epirit. Para se të vdiste, për trashëgimtar emëroi Teodor Engjëllin, vëlla nga nëna, i cili bëri çmos që “Despotatin e Epirit” ta shndërrojë në një fortifikatë ortodokse të Bizantit në luftë kundër perëndimorëve, të cilët me “*Perandorinë latine në Kostandinopojë*” ndodheshin në Kostandinopojë dhe me pjesën e “Perandorisë Latine” në Selanik. Me rastin e marrjes së fronit nga i vëllai, Teodori i bashkoi emrit të tij emrat e tre dinastive perandorake: të Engjëllorëve, Dukëve dhe Komnenëve,<sup>471</sup> duke u quajtur kështu Teodor Engjëll Duka Komneni, që si do të shihet kjo do të zgjojë rivalitetin midis dy qendrave bizantine, të cilat luftonin për ta rikthyer fronin e Bizantit në Kostandinopojë.

Nën drejtimin e Teodor Engjëllit “Despotati i Epirit” po merrte formën e një shteti autonom, me rëndësi gjithnjë e më të madhe. Fisniku luftarak, tashmë kishte shtënë në dorë viset nga Durrësi deri në gjirin e Korintit me qendrën në Artë. Kështu, shteti epirot, si një principatë bizantine në qendër të Ilirikut, njëlloj si “Perandoria e Nikesë” në Azinë e Vogël, përfaqësonte një qendër të rëndësishme të vazhdimësisë kulturore bizantine dhe një bërthamë të unifikimit politik, që bashkonte tri etnitë e dikurshme të antikitetit: epirote, dardane dhe maqedonase.<sup>472</sup>

Mbi këto parime ajo iu kundërvu si një principatë e pavarur “Mbretërisë Latine” të Selanikut, Venedikasve në Adriatik, Sllavëve në Veri e Verilindje. Në vitin 1216 Teodori arriti një sukses shumë të madh pasi që shkëputi një krah latin, që mbante peng Bizantin, siç ishte “*Mbretëria Latine e Selanikut*”. Para se ta arrijë këtë, Teodori e zuri rob në Durrës perandorin latin të Selanikut, Pjetër de Courtenay (Kurtënë), i cili paraprakisht kishte qëndruar në Romë dhe atje nga

<sup>471</sup>Mihali dhe Teodori ishin djemtë e *sebastokratit* Johan Engjëlli. I pari jolegjitim dhe i dyti legjitim. Emrin Dukas e kishte marrë nga e ëma e tij, atë të Komnenit nga gjyshja e tij Teodora, bija e Aleksit I. (Shih: Nicol, D: “*The Despotat of Epiros*”, Oxford, 1957 dhe Zachariadou, e. A: “*Marginalia on the History of Epirus and Albania 1300-1418*”, Wiener Zeitschrift für Kunde des Morgenlandes 78, 1988).

<sup>472</sup>Nicol, D: “*The Despotat of Epiros*”, Oxford, 1957, faqe 309.



Papa Honorius III vuri kurorën e Perandorisë Latine. Pjetër Kurtënë, burri i Jolandës, motrës së Balduinit dhe Henrikut, për të dëshmuar triumfin e kurorëzimit në Romë duhej të kalonte nëpër Durrës për të vazhduar rrugën për në Kostandinopojë. Pas këtij sukse si të madh, Teodor Engjëll Duka Komneni ndërmoi një fushatë të gjerë kundër Latinëve. Natyrisht se çak i tij i parë ishte mbretëria fqinje e Selanikut, e cila nuk kishte gjasa që t'i bënte ballë, pasi që kalorësit që e kishin themeluar ishin kthyer në vendet e tyre. Princi epirot e mbajti të rrethuar për disa kohë “*Mbretërinë Latine të Selanikut*”, deri në fund të vitit 1224 kur edhe u fut në të. Ishte ky njëherësh fundi i njërit ndër shtetet kryqtare të krijuara në tokën bizantine. “*Despotati i Epirit*”, tashmë shtrihej nga Adriatiku deri në Egje dhe përfshinte edhe Thesalinë e një pjesë të mirë të Maqedonisë.

Këto sukse bënë që Teodor Engjëll Duka Komneni ta shihte veten perandor. U quajt *basileus* dhe *autokrator* i Romejve, duke mbajtur veten për trashëgimtar të fronit të Bizantit si dhe prijës i betejës për Kostandinopojën, me çka i kundërvihet hapur Perandorisë së Nikesë.<sup>473</sup>

Sukse i Teodor Engjëll Duka Komnenit ndaj Latinëve, ku kishin marrë pjesë edhe ushtarakë dhe feudalë arbërorë nga pjesët e Epirit, frikësoi së tepërmi Perëndimin, të cilët do të bëjnë çmos që ta shpëtojnë “*Perandorinë latine të Kostandinopojës*” nga Teodor Engjëlli dhe fuqia e tij epirote. Por, atë që nuk ishte në gjendje ta bënte Roma, në mënyrë që Teodor Engjëll Duka Komneni të mos përfundonte në Kostandinopojë si perandor i Bizantit, e bëri “rivali” i tij, cari i Bullgarisë Jan Aseni II, i cili, para se ata të afrohen te caku, Teodor Engjëllit ia luajti lojën dhe në Edrene, me një ushtri të madhe, ia preu rrugën. Aty Teodor Engjëll Duka Komneni pësoi humbje të thellë nga Bullgarët, ku zu rob dhe u verbua.

Me këtë humbje nga Bullgarët, “*Perandoria Bizantine e Selanikut*” u shkatërrua, ndërkohë që “*Despotati i Epirit*” u kthye në kufijtë e mëparshëm dhe vazhdoi si mbretëri më vete edhe për disa vjet të tjera,<sup>474</sup> deri atëherë kur bullgari Jan Aseni II iu kthye ëndrrës së dikurshëm të mbretit, Boris dhe, pasi pushtoi Maqedoninë, shtroi edhe vendet e Ilirikut deri në Durrës.<sup>475</sup>

Gjatë kësaj fushate Bullgarët prapë u fuqizuan në Ilirikun qendror dhe jugor, qoftë duke lidhur për vete despotët e Rashës, qoftë duke mbajtur lidhje të mira

---

<sup>473</sup>Shih: Langon, J: “*La reprise de Salonique par les Grecs en 1224, Actes du VI Congres Intern. d’Etudes Byz.*”, I (1950) dhe Prinzing, Gunter: “*Studien zur Provinz und Zentralverwaltung im Machtbereich dre Epirotischen Herrscher Michael I und Theodoros Dukas*”, 1982.

<sup>474</sup>Po aty, faqe 109.

<sup>475</sup>Vasilev, A: “*History of the Byzantine Empire*”, faqe 525.

me trashëgimtarët e mbretit gjerman Henrikut, të cilët për kundërshtarë të përbashkët kishin Latinët dhe Normanët. Mbi këto aleanca dhe të vendosur që të eliminojnë me çdo kusht rivalitetin e Nikesë për fronin e Bizantit, Bullgarët kërkuan të lirohen nga kurora e Kishës Romane. Por, meqë këtë nuk dëshironin ta bënin që t'i binin në dorë Kishës Lindore, pra asaj të Kostandinopojës, “autorizimet” e të cilës tashmë gjendeshin në Nike, Aseni II shfaqti idenë e themelimit të një *Patriarkati Ortodoks* në Tërnovo, që do të njihej nga Nikea dhe nga patriarkët lindorë. Krerët kishtarë të Nikesë e pranuan zemërthyer këtë, nga druajtja se mospranimi do ta shtynte Bullgarinë në gjirin e Romës, me pasojë të mëdha politike, të cilat më së paku i dëshironte perandoria e dëbuar, e cila priste kthimin. Kështu, me themelimin e *Patriarkatit bullgar*, Bullgaria fitonte pavarësinë kishtare, siç e fitonte edhe kisha e Rashës, e cila përdori thujtë të njëjtat dredhi si edhe ajo bullgare. Këto kisha, megjithatë, duhej ta njihnin primatin e patrikut të Nikesë, të përmendnin emrin e patrikut bizantin në shërbesa fetare dhe t'i paguanin atij tribute.

Traktati i tolerancës midis tri kishave bizantine nënshkruhet në pranverën e vitit 1235 në Galipoli, ku edhe u shpall posti i ri i kishës bullgare. “Pajtimi” upërcoll me solemnitet me martesën e të birit të perandorit Teodori II Laskari me vajzën e mbretit të Bullgarisë.

Edhe përkundër kësaj “krushqie”, Mbretëria Bullgare e Jan Asenit II nuk e pati gjatë. E ngritur mbi prapaskena tepër të mëdha, që bëheshin nga të tri anët, ajo u shemb në vitin 1241, pas vdekjes së Jan Asenit II, në kohën kur ishte afër për të lidhur një aleancë me Latinët dhe Kumanët kundër Nikesë. Kjo i dha shkas të mirë Jan Vatacës të rikthejë tokat bizantine të Trakisë dhe të Maqedonisë për ta pushtuar Selanikun në vitin 1246.

“*Despotati i Epirit*”, me një intensitet më të ulët, edhe më tutje përfshihet në përvijimet e brendshme të perandorëve bizantinë për pushtet pasi në krye të Bizantit erdhi Mihal Paleologu 1259. Paleologu vetëshpallet perandor, por do të kundërshtohet nga despoti i Epirit, Manueli II, i cili rrëmujën e Perandorisë së Nikesë, e shfrytëzoi për ta mvetësuar “*Despotatin e Epirit*” nga ndikimi i Paleologut. Kështu, ai thirri në ndihmë mbretin e Sicilisë, Manfredin, bir pa kurorë i perandorit gjerman, Frederikut II. Po ashtu thirri në ndihmë princin e Moresë, Guljem de Villehardouin. Po në të njëjtën kohë Mihal Paleologu mblodhi një ushtri mercenare me Turq, Tartarë, Sllavë e Grekë dhe marshoi kundër Manuelit II. Beteja u zhvillua në fushën e Pellagonisë afër Kosturit. Manueli me gjithë

aleatët e tij pësuan një disfatë të rëndë. Kështu, mori fund “*Despotati i Epirit*” duke u kthyer në një provincë të Perandorisë bizantine.<sup>476</sup>

Pak më vonë u shkatërrua edhe “*Perandoria Latine e Kostandinopojës*”. Më 13 gusht 1261, pikërisht pas 130 vitesh, Mihal VIII Paleologu hyri me ceremoni të madhe në kryeqytetin historik të mbretërisë së tij dhe u kurorëzua solemnisht në katedralen e Shën Sofisë.<sup>477</sup>

Në këtë mënyrë Bizanti bashkoi shumë nga territoret e shkëputura nga vitit 1204 dhe filloi projektet e njohura restauruese, që asnjëherë nuk ua doli mbanë.

Rënia e “*Perandorisë Latine të Kostandinopojës*”, siç mendohej, nuk ia ndali rënien përfundimtare Bizantit. Proceset shthurëse vazhduan edhe më tutje, por në fazën përfundimtare, ato nuk shkuan në drejtim të rikthimit të qendrës bizantine nga Latinët. Te shkapërderdhja e saj nga brenda rol të veçantë dhe vendimtar patën princat vasalë të deridjeshëm të perandorëve bizantinë, në radhë të parë ata Rasiënë, Bullgarë dhe Grekë. Në këtë zhvillim, në mënyra të ndryshme, ata u përdorën nga vendet katolike të Perëndimit, të drejtuara nga Vatikani. Do të shihet se këtu edhe faktori arbëror, që kishte filluar të shfaqej në skenën politike të Ilirikut, siç ndodhi me rastin e “*Despotatit të Epirit*”, i quajtur edhe “*Despotat Arbëror*”,<sup>478</sup> ndonëse i shkapërderdhur nëpër principata të ndryshme, fitoi peshë të veçantë dhe të pakapërcyeshme madje. Kjo bëri që vendet katolike të Perëndimit në krye me Vatikanin, të përqendroheshin tek ata dhe fuqia e tyre për interesat e tyre.

Në të vërtetë faktori ilir në këtë pjesë të rëndësishme që etnikisht dhe politikisht po shfaqej si *arbëror*, i gjendur në një zhvillim ngjarjesh ndër më të ashprat për nga kthesat që do ta përfshijnë Perandorinë e Bizantit midis shekujve XI-XIV, veçmas nga koha kur do të fillojnë kryqëzatat dhe shfaqja e Normanëve si fuqi lëvizëse në Perëndim (nga Kryqëzata e Parë 1097 e deri te ajo katërta 1204), do të rreshtohet në anën e mbrojtësve të Bizantit dhe të ngrehinës së tij, meqë ishte ndër themeluesit e ligjshëm të tij. Këtë madje e bëri edhe atëherë kur nga koha e perandorit Heraklit e këndej, do t’u vihet në dyshim statusi tejet i rëndësishëm i faktorit ndërlidhës midis Perëndimit dhe Lindjes (si provincë lindore e Perandorisë - që nga reformat e perandorit Dioklecian, por nën juridiksionin kishtar të Selisë së Shenjtë pra të Romës - me novelën e perandorit

---

<sup>476</sup> Po aty, faqe 527.

<sup>477</sup> Zavalani, Tajar: “*Histori e Shqipnisë*”, Tiranë, faqe 110.

<sup>478</sup> Vasilev, A: “*History of the Byzantine Empire*”, faqe 525 dhe Xhufi, Pëllumb: “*Nga Paleologët te Muza-kajt*”, Tiranë, 2009.

Justinian I). Këtë status, ndonëse do ta humbin në shekullin IX pas shfaqjes së mbretërisë bullgare dhe rënies nën pushtimin e tyre bukur të gjatë, megjithatë, çatia bizantine, pa marrë parasysh sa do t'i mbrojë nga "motet e liga", mbetej e vetmja mbështetje. Kjo do të tregohet edhe me rastin e zhvillimeve pas Kryqëzatës së Parë e këndeje, që ndonëse do të preken të parët, do të rreshtohen në mbrojtje të Bizantit, siç u pa edhe me themelimin e "Despotatit të Epirit". Këtë do ta bëjnë edhe atëherë, kur Sllavët, që në Veri dhe Lindje ua kishin rrudhur së tepërmi hapësirën etnike dhe do t'u kthehen në kundërshtarë kryesor dhe rrënues të identitetit të tyre etnik dhe shpirtëror. Edhe pas Kryqëzatës së Katërt, kur ra Kostandinopoja në duart e kryqtarëve latinë dhe erdhi te copëtimi i saj në katër pjesë (dy në anën e Perëndimit: Perandoria Latine e Kostandinopojës dhe Mbretëria Latine e Selanikut; dhe Perandoria e Nikesë dhe Despotati i Epirit në anën e Bizantit), Arbrit, për afër gjysmë shekulli, thaujse të vetmit, kthehen në mbrojtës të Bizantit. Engjëllorët dhe Komnenët vepruan që ta mbajnë të gjallë trungun dhe shpirtin e Bizantit në pjesën perëndimore, pra në Epir, Maqedoni dhe Thesali e deri në Bosfor, ku më së shumti do të kërcënohet nga perëndimorët. Dhe, sigurisht se Teodor Engjëll Dukë Komneni, do t'ia dilte që nga Selaniku të merrte Kostandinopojën që mbahej nga Latinët, e cila ishte para shembjes, po mos të ishte rivaliteti i Jan Vatacit të Nikesë, në pjesën e shkëputur të Azisë së Vogël, që kurorën e Bizantit e lypte për vete, dhe po ashtu, po mos të ishte Bullgari Ivani II Aseni, i cili në aleancë me despotatin e Rashës dhe me Latinët, në vitin 1230, ia preu rrugën në Traki, pasi që kishte pushtuar Adrianopojën dhe ndodhej afër Bosforit.

Nga ajo kohë, "*Despotati i Epirit*", ndonëse i kthyer në një vasal të perandorit të Nikesë, do t'i kuptojë realitetet e reja, që flisnin për fundin e Bizantit dhe të idesë së një perandorie të madhe. Ajo ishte e gjykuar që të binte njëherë e përgjithmonë, kështu që, në përputhje me këtë zhvillim dhe faktorët e rinj duhej rreshtuar dhe vepruar.

Dhe faktorë "të rinj" force, krahas Turqve që kishin filluar të depërtonin nga të gjitha anët, veçmas nga Lindja dhe me aleancat e tyre herë të hapura e herë të fshehura po krijonin rrethana të favorshme për vete, tashmë ishin vendet perëndimore, të cilat kishin hyrë në lojë duke u mbështetur të shumtën në faktorin vendor (despotët dhe princat Bullgarë, Sllavë, Grekë dhe Arbrit). Meqë e kishin të qartë se Bizanti nuk mund të kthehej në Romë, siç ishte tentuar me "*Perandorinë Latine të Kostandinopojës*" (një krijesë e dhunshme e fanatikëve katolikë që e kishte komprometuar katolicizmin), atëherë Selia e Shenjtë, me aleatët e vet, do

të përqendrohet që nga faktorët vendorë, kundërshtarët e Bizantit dhe të gjithë ata që kishin ambicie për pushtet, të krijojnë shtete apo *mbretëri perëndimore* në këtë hapësirë, të cilat do t'ua mbronin interesat në këtë pjesë, në radhë të parë duke i kthyer ata në digë mbrojtëse kundër Osmanëve.

Fryt i këtij projekti duhet parë edhe shfaqjen e “*Mbretërisë së Arbërisë*”, themeluar në vitin 1272 nga Karli i Parë i mbretërisë Anzhue, që paraprakisht kurorën e Mbretërisë së Sicilisë e fitoi në luftë me mbretin e Sicilisë, Manfredit Hohenshtaufen, pasi që këtë nga i vëllai i mbretit të Francës e kërkoi Papa Inocenti IV, i cili me rrëzimin e Hohenshtaufenëve nga fronin kishte për qëllim të krijonte mundësitë që Anzhutë të luftonin kundër Perandorisë Bizantine të rimëkëmbur në truallin e saj dhe me faktorët e saj përbërës. Arbëria paraqiste njërin ndër vendet më të përshtatshme për këtë qëllim, nga do të shkohej më këndeje në drejtim të Lindjes.

Para se të themelohej “*Mbretëria e Arbërisë*”, e cila paraqet kthesë të rëndësishme, jo vetëm për Arbrit, po edhe për zhvillimet e mëtejshme në Europë në prag të depërtimeve të Osmanëve, me të cilat do të ndryshohet kahu i historisë, duhet parë disa zhvillime që do të çojnë deri tek ngritja e faktorit arbëror në shkallën e një aleati të rëndësishëm të Perëndimit në luftë për të përfituar dhe për të përvetësuar sa më shumë që të jetë e mundur nga dobësimi i Bizantit. Grahma e Bizantit për Perëndimin nuk do të thoshte vetëm fund i një kundërshtari, por njëherësh edhe fillim i një shqetësimi rreth asaj se kush do të mund ta trashëgojë atë, veçmas kur dihej se pretendentët kryesorë – Rasianët, ishin më të paparashikueshëm nga prirjet e tyre për aleanca të mundshme me Osmanët, të cilët po ashtu lidheshin me qëndrimin e pashpallur të Patrikanës së Kostandinopojës që ruajtja e hapësirës së ortodoksisë nga “ripushtimi katolik” të bëhej goftë edhe me ndihmën e Osmanëve!

Në këto rrethana Selia e Shenjtë, ndonëse me maturi, sërish do të shpallë haptas qëllimet e Perëndimit që të depërtojë në pjesën që nga shfaqja e “*Despotatit të Epirit*” e këndeje, me të drejtë quhej edhe *Bizanti Arbëror*, nga aty të marrë përsipër ngrehinën në shembje e sipër të Bizantit, para se ajo të bëhej pre e dinastisë Nemanjase të Rashës apo Bullgarëve, të cilët po forcoheshin në dëm të saj dhe dita-ditës po ia zinin vendin duke i dhënë gjithë çështjes një kah të paparashikueshëm dhe me rreziqe për Perëndimin. Ky zhvillim për Perëndimin ishte njësoj shqetësues si dhe humbja e fuqisë mbrojtëse të Kostandinopojës në Lindje në luftë me Turqit Selxhukë. Kështu, Papa Inocenti IV, u vu haptas në anën e Karlit të Parë Anzhu, një force premtuese europiane për ta nxitur, së pari kundër

mbretit të Gjermanisë, Manfredit të Hohenshtaufenit dhe pastaj edhe kundër vetë Bizantit.<sup>479</sup>

Këto luftëra, ai i fitoi, së pari më 1266 në betejën e Beneventit kundër Gjermanëve dhe pastaj kundër Mihalit II të Bizantit. Papa Inicienti IV këtë do ta bëjë me një gjuhë tjetër nga ajo që kishte përdorur deri më atëherë Selia e Shenjtë, e cila vazhdimisht ishte munduar që çështjet e bashkimit kishtar t'i ndante nga ato të politikës, të cilat, në të vërtetë kishin nxitur shqetësimin e Perëndimit, meqë nga aftësia ose paaftësia e Lindjes që t'u bënte ballë sfidave ekzistenciale, siç ishte ajo e depërtimit osman, varej edhe e ardhmja e saj dhe e gjithë krishterimit.

Natyrisht se Anzhotë, në marrëveshje me papën, në përpjekjet e tyre për ta pushtuar ngrehinën e pasigurt të Bizantit, së paku në pjesën më të madhe të Ilirikut, për synim kryesor kishin marrjen e vendeve që tashmë njiheshin si të Arbrit dhe vënien e tyre nën mbikëqyrje, por që e gjithë kjo, si baraspeshë kundër Rasianëve, Grekëve dhe Bullgarëve, të ngrhte një mbretëri të tyre, e cila do të shfaqej si aleate e përhershme e Perëndimit dhe e krishterimit perëndimor në përgjithësi, ku Arbëria shihej si një pikë e rëndësishme drejt rikthimit të Perandorisë së Romës në Lindje, paçka se pjesa më e madh e feudalëve arbërorë i takonin kishës lindore. Madje, edhe pse me zhupanët e Rashës (Stefan Nemanjën) dhe me Bullgarët, Karli I Anzhu, në vigjilje të zbarkimit në pjesën tjetër të Adriatikut, pati disa biseda me të cilat përpiqej t'i lidhte për planet e veta (me lidhjen e disa aleancave të fshehta me Rasianët, siç ishin ato për Dioklenë dhe Raguzën), kjo nuk ndryshoi qëndrimin për rolin dhe vendin e Arbrit në këtë zhvillim me sa më shumë faktorë vendorë që ishin të lidhur me Bizantin, apo që kishin interes nga dobësimi ose shembja e tij. Por, duke u përqendruar te hapësira e *Bizantit arbëror* (me këtë mendohet pjesa e Epirit, Dardanisë dhe e Maqedonisë si një portë e pakalueshme, që përherë hapte dyert për në Kostandinopojë), Karli I Anzhu kërkonte të gjente "atu" në të drejtat e tij në vijë trashëgimtare mbi zotërimet e Manfredit në Arbëri, duke i shndërruar në vasalë të tij bashkëpunëtorët e Manfredit në Arbëri. Kështu, Karli I Anzhu emëroi si mëkëmbës në Arbëri, Gaco Kinardin, një i afërm i mëkëmbësit të vvarë të Manfredit, Filipit. Bëhet e ditur se

---

<sup>479</sup> Rrethanat e vendosjes së sundimit të *Manfred Hohenstaufenit* në Epir nuk shfaqen gjithaq të qarta. Dihet vetëm se në këtë kohë, kishte shpërthyer një kryengritje antibizantine, të cilën Georg Akropolites e quan "*kryengritje e popullit shqiptar*" (το των Αλβανιτων εννοος), ku administrata bizantine ishte në rrëmujë të plotë dhe vetë qeveritari bizantin, Konstanin Habarani, ra viktimë e një komploti të thurur nga despoti Mihali II Engjëlli i Epirit. Me sa duket ky u konsiderua momenti më i përshtatshëm për Manfredin, që të fillonte zbatimin e planit të tij ambicioz në Lindje. Në një akt privat, hartuar në Durrës diku para shkurtit të 1258 Manfred Hohenstaufen ishte zot i Durrësit, Vlorës, Beratit dhe i "lartësive të Spiranicës". (Shih: Xhufi, Pëllumb "*Nga Paleologët te Muzakajt*", Tiranë 2009, faqe 106-111)

para se të zbarkojë në bregdetin e Arbrit, me anën e dy priftërinjve katolikë: Gjonin nga Durrësi dhe Nikolla nga Arbri, ai kishte vendosur një lidhje të mirë me disa nga aristokratët dhe fisnikët e Arbrit. Si besimtarë të mbretit Karl dhe të aleatit të tij të madh, Papës Grigorit X, bënë disa udhëtime midis Napolit dhe Durrësit, duke përcjellë porositë e mbretit të krerët e Arbrit.<sup>480</sup>

Me premtimin e bashkimit dhe të forcimit të tyre drejt mvetësimit nën kryqin katolik, Karli i Parë Anzhu nuk e pati të vështirë t'i bënte për vete shumë nga bujarët dhe fisnikët e Arbrit, pasi që të ketë zbritur në Durrës në vitin 1272 dhe prej andej, me ushtrinë e përgatitur mirë për një luftë tjetër kundër Mihalit të dytë, ia doli që bujarëve arbërorë t'ua kthejë pronat dhe zotimet e tyre që ua kishte marrë Bizanti pas rikthimit. Pasi që gjatë depërtimeve të mëtutjeshme, në pjesën kontinentale, familjet e njohura arbërore i shpërbleu me ofiqe dhe me prona të mëdha, Karli I Anzhu kishte krijuar të gjitha rrethanat e nevojshme për formimin e “*Mbretërisë së Arbërisë*” (*Regnum Albaniae*) në mënyrë që edhe veten ta shpallë “*Mbret të Arbërisë*” (*Rex Albaniae*).

Ndër këto rrethana, që do t'i shkojnë për shtati shfaqjes së tij në Arbëri, gjithsesi duhet përmendur ato që do t'i paraprijnë kohës kur ai do të marrë masat që nga ana e Arbërve të njihej sovran i përbërës “pa dhunë e shtrëngim”, gjë që nënkuptonte një marrëveshje sipas së cilës Karli I Anzhu fisnikëve dhe bujarëve arbërorë ua njihte ruajtjen e të gjitha privilegjeve që ua kishte akorduar atyre perandoria e hershme e Bizantit, si dhe respektimin e të gjitha “zakoneve të mira e të traditave të tyre”.<sup>481</sup> Ruajtja e pronave dhe garancitë që u jepeshin feudalëve dhe despotëve vendorë, ishin parakusht për pranimin e vasalitetëve, të cilat kënaqnin ata, por edhe zotëruesit e rinj, pa marrë parasysh me çfarë kurora shfaqeshin.

Mbi këto parime veproi edhe Karli I Anzhu, i cili do të shpallë “*Regnum Albaniae*” dhe veten “*Rex Albaniae*” në Napoli, më 21 shkurt të vitit 1272.<sup>482</sup>

Themelimi i “*Mbretërisë së Arbërisë*”, në vitin 1272, që për katërmbëdhjetë vjet mbijetoi sfidat e brendshme dhe të jashtme, paraqet një faktor të rëndësishëm, jo vetëm për Arbrit, të cilët deri më atëherë kishin qenë ndër më të përkushtuarit në mbrojtjen e ngrehinës së Bizantit, pse e ndjenin të tyren, por edhe për faktorët e tjerë nga brenda dhe nga jashtë, meqë vendet e Arbrit sërish kthe-

---

<sup>480</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, pjesa e parë, Tiranë, 2002, faqe 240.

<sup>481</sup> Ndër këto rrethana gjithsesi se përmenden ato që kanë të bëjnë me misionarët që Karli I Anzhu i dërgoi tek fisnikët dhe feudalët arbërorë. Ishte fjala për disa klerikë katolikë vendas. (Shih: *Acta Albaniae*. I, 802).

<sup>482</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, pjesa e parë, Prishtinë, 1969. Faqe 188/189

heshin në një nyjë të rëndësishme që përcaktonte raportet e forcës midis Lindjes dhe Perëndimit.

Kështu, në rrethanat e reja kur Bizanti nuk mund të mbahej më, ndërkohë që Perëndimi kishte bërë të ditur se Arbrit dhe Arbëria, pavarësisht shkapërderdhjes së tyre në dy rite dhe pasojave që mund të sillte ky realitet kishtar, ishin ata që mund të ktheheshin në një fuqi të rëndësishme perëndimore në hapësirën e Bizantit, ku ata mund të mbështeteshin dhe madje mbi ta të krijonin një digë të gjerë mbrojtëse ndaj depërtimeve osmane, do të ballafaqohet me dy sfidën e dy fronteve “të brendshme”. Në njërën anë nga ajo që shfaqej si mbetje e Bizantit, por që nuk ishte tjetër pos një përzierje bullgare-greke, dhe në tjetrën anë, nga despotët tribalë rasianë (Nemanjajt), të cilët kishin treguar prirje për lojëra të dyfishta, të shumtën në dëm të Arbërve dhe të strukturave të tyre shoqërore dhe politike nga ato të bujarëve e deri te principatat e tyre.

Në këtë luftë Bizanti tashmë i shprishur kërkonte që me çdo kusht të rikthente pushtetin e humbur ndaj perëndimorëve në vendet e Arbrit, meqë ato kishin një rëndësi të veçantë strategjike pse nëpër to kalonin rrugët ujore dhe tokësore, që lidhnin Lindjen dhe Perëndimin, mbikëqyrja e të cilave krahas pushtetit politik do të thoshte edhe pushtet ekonomik, por edhe për atë se Arbrit, deri dje mbrojtës të Bizantit, në përputhje me rrethanat që kishte sjellë zhvillimi i feudalizmit dhe krijimi i feudeve autonome, me feudet e tyre po shfaqeshin si faktor autonom mbi të cilin ndërtonin pushtet të pavarur. Ndërsa Rasha, e ndihmuar edhe nga Grekët, tek forcimi i mëtejshëm i “*Mbretërisë së Arbërisë*” shihte një rrezik të dyfishtë: në njërën anë, faktorizimin e tyre të madhe në Ilirik dhe kjo nuk mund të bëhej pa koston ndaj pretendimeve të tyre gjithnjë e më të hapura që të shfaqeshin si trashëgues të Perandorisë bizantine në ikje e sipër. Në tjetrën anë, për Rasianët, ishte e papranueshme që Arbrit dhe mbretëria e tyre, ndonëse popullata arbërore në shumicë i takonte ritit lindor, të kthehej në një mbështetëse të katolicizmit në ekspansion e sipër në këtë pjesë të Bizantit, meqë me ndihmën e saj vlerësohej se Perëndimi do të fitonte mundësitë që të depërtonte më tutje në drejtim të Kostandinopojës dhe një ditë edhe ta pushtonte fare.

Pra, për ndryshim nga pushteti i Bizantit, i cili kur rikthehej, siç ndodhi pas rikthimit të Kostandinopojës në vitin 1261 nga perandori Mihali VIII Paleologu, megjithatë kishte kujdes që fisnikërinë arbërore në forcim e sipër të mos e dobësojë, por ta kthejë në një digë mbrojtëse kundër depërtimit të perëndimore në pjesën lindore, Rasianët, ndiqnin qëllime të kundërta: ato të përthithjes



shoqërore dhe politike të faktorit arbëror dhe të futjes nën sjetull, siç do të veprohet në kohën e Stefan Dushanit.

Në këto hesape të dyfishta midis Bizantit për forcimin e tij në pjesën arbërore dhe të Rashës që ajo t'i fitonte tapitë e Perandorisë Lindore në shuarje e sipër, "*Mbretëria e Arbërisë*" duhej ndalur me çdo kusht para se të kthehej në faktor kyç, që mund ta vendoste përfundimisht luftën e brendshme të kryqit në dobi të katolicizmit dhe me këtë vija e perandorit Teodosi nga shekulli i katërt të shkente këndeje kah Lindja, deri aty ku Perëndimit i interesonte, por që tash ajo të kthehej në vijë të ndeshjes me Osmanët.

### “MBRETËRIA E ARBËRISË” DHE PUSHTIMET RASIENE

E shikuar nga pikëpamja e sferave të interesit Lindje-Perëndim dhe raportet më të gjëra që do të përvijohen në përpjekjet e gjata për pushtet midis kishës katolike dhe asaj ortodokse, shfaqja e "*Mbretërisë së Arbërisë*" dhe me të e Karlit I Anzhu, "*Mbret i Arbërisë*", me të drejtë hap çështjen e rëndësisë së faktorit arbëror nga Mesjeta si dhe rolit të tij tejet të madh për përcaktimin e kufirit të sferave të interesit në njëerën apo tjetrën anë. Edhe pse historiografia shqiptare të shumtën me ngarkesat e koncepteve të njohura ideologjike të së kaluarës dhe mungesën profesionale këtë e ka anashkaluar, ndërsa historiografia serbe, greke dhe ruse është munduar ta zvogëlojë, duke e parë atë vetëm si "*përpjekje të dështuar, apo si një insert ndër të shpeshtit e asaj natyre të papatit dhe dinastisë së Anzhuve për të dobësuar Bizantin me anën e përdorimit dhe të manipulimit të popullatës së Arbrit për ato qëllime*",<sup>483</sup> megjithatë, ajo që ndodhi gjatë katërmbëdhjetë viteve të shfaqjes së "*Mbretërisë së Arbërisë*" paraqet më shumë se një luftë të hapur midis Lindjes dhe Perëndimit për interesa të tyre, që doemos prekte edhe interesat jetësore dhe kulturore të atyre që përfshiheshin në të, duke i kthyer në kundërshtar dhe armiq madje, siç kishte ndodhur edhe me një pjesë të fisnikëve dhe bujarëve arbërorë të mbetur nën Bizant (Gjin Muzaka, zot i zonës së Dibrës dhe asaj të Beratit dhe të tjerë), që do të luftojnë në anën e Bizantit, paçka se do të ketë edhe të tillës, siç ishte rasti i Pal Gropës, i cili, ndonëse jashtë sovranitetit të Karlit I Anzhu dhe "*Mbretërisë së Arbërisë*", radhitet në anën e vasalëve të tij, me çka do t'i njihen që të gjitha zotimet që kishte në pjesën e Dibrës dhe të Ohrit,

---

<sup>483</sup> Ostrogrorski, Georg "*Historia e Perandorisë Bizantine*", Tiranë 2010, faqe 281.

edhe atëherë kur vijnë njoftime se do të gjendet në anën e Bizantinëve kundër tij.<sup>484</sup>

Të dhënat e ndryshme tregojnë se mobilizimi për dhe kundër “Mbretërisë së Arbërisë” do të jetë në njërin anë për kryqin ortodoks dhe Lindjen dhe në tjetrën anë për kryqin katolik dhe Perëndimin. Në këtë luftë që duhej të vendoste për zhvendosjen e vijës së Teodosit nga shekulli i katërt dhe asaj të ndarjes përfundimtare të kishave dhe të armiqësismit të tyre të hapur në vitin 1054, faktori arbëror tashmë nuk kishte vetëm rolin e thjeshtë, të atij me të cilin bëheshin hesape, siç kishte ndodhur deri më atëherë, pa u përjashtuar këtu edhe koha e “Despotatit të Epirit” që duhej të vendoste për relacionet e forcës midis Bizantinëve, por kishte rolin edhe të hesapçiu, në hesapin e madh të dy krahëve të Perandorisë së dikurshme, të cilat luftonin për sa më shumë hise. Në këto rrethana, një pjesë e bujarëve, feudalëve dhe fisnikëve arbërorë, të cilët kishin humbur besimin te Bizanti dhe fuqia e tij, tashmë e kishin të qartë se nuk ishte vetëm kurora mbretërore e Arbërisë në kokën e Karlit I Anzhu, e sjellë nga Napoli ajo që ata i shtynte për ta mbrojtur atë. Për më tepër, ishte pozita shoqërore e ndërtuesit të mbretërisë, ku ata tashmë ishin të bashkuar thuajse gjithandej nga shtriheshin tokat e tyre, dhe për herë të parë shihnin se luftonin për një pushtet të brendshëm, që ndonëse i mbikëqyrur nga jashtë, ai po kthehej në shtet të tyre dhe si i tillë vepronte. Madje, ndjenjën e një vetëpronësimi, që duhej forcuar dhe bërë për veti sa më shumë, edhe pse vinte nga jashtë, popullata arbërore e fitoi edhe atëherë kur Mihali VIII Paleologu, ia doli që me anën e premtimeve të dërguara me anën e emisarëve të ndryshëm, në vitin 1275, të ndezë disa kryengritje të feudalëve vendorë të lidhur në forma të ndryshme me Grekët, të cilët do të deklarohen si Arbërorë për t’i nxitur edhe të tjerët me pretekstet se bujarët e ardhur nga Italia dhe Franca kishin uzurpuar shumë nga pronat vendore dhe ndaj popullatës vendëse silleshin si pushtues”.<sup>485</sup>

Feudalët, fisnikët, kontët dhe bujarët e Arbrit, edhe përkundër disa lëkundjeve, siç ishin ato që u shfaqën një kohë të Blinishtët dhe Sgurajt, sërisht do ta mbështesin Karlin I Anzhu në luftë kundër Bizantit. Këtë do ta bëjnë edhe atëherë kur Paleologu, në saje të ndihmave që do t’i vijnë nga vullnetarët Grekë dhe ata rasianë, arrijë deri tek muret e Durrësit.

Para se “lidhja bizantine” ta merrte Durrësin, në të cilën, krahas Grekëve dhe Rasianëve, ishin të përfshirë edhe disa fisnikë arbërorë, pronat e të cilëve i ndante

<sup>484</sup> Xhufi, Pëllumb: “Nga Paleologët të Muzakajt”, Tiranë 2009, aq. 124.

<sup>485</sup> “Historia e Popullit shqiptar”, pjesa e parë, Prishtinë, 1969, faqe 189.

“kufiri i kishave të ritit ortodoks me atë katolik” dhe në ato rrethana për herë të parë luftonin “në anë të ndryshme”, beteja vendimtare do të zhvillohej për Berat, ku ishin përqendruar Bizantinët dhe aleatët e tyre, të cilët për qëllim parësor kishin rrënimin e “*Mbretërisë së Arbërisë*”. Mbreti Karl I Anzhu ishte i detyruar që të ndërmernte një fushatë në këto pjesë të rebeluara që iu kishin bashkuar Bizantit, ani pse ajo i fuste në një luftë të brendshme fisnikët dhe kontët arbërorë, të atyre që do të duhej të paraqisnin bërthamën kryesore të “*Mbretërisë së Arbrit*”. Që ajo të ishte sa më pak luftë me njëri-tjetrin e më shumë konfrontim me Bizantin, Karli I Anzhu lidhi një aleancë me atë që shfaqej si mbetje e “*Despotatit të Epirit*”, e cila drejtohej nga despoti Niqifor dhe dukej se ai kishte ndikim në këtë pjesë, veçmas te disa feudalë arbërorë. Ai u shpall vasal i mbretit Anzhuin dhe i dorëzoi këtij kështjellën e Butrintit, të Sopotit e të Porto-Palermos. Me këtë mund të thuhet se Niqifori, i cili deri më atëherë qëndronte midis Bizantit dhe Karlit I Anzhu, që ishte eksponent kryesor i Perëndimit në luftë kundër Perandorisë së Kostandinopojës, përcaktohet për Perëndimin, duke pranuar kështu “*Mbretërinë e Arbrit*”, edhe përkundër asaj që vazhdonte të mos njihej por edhe të luftohej nga disa fisnikë arbërorë në anën e Paleologëve, që mund të thuhet se nuk kishin më hallin e Bizantit, por të mbijetimit në këto pjesë, ndonëse si thika me dy tehe, ngaqë ishin kthyer në faktor përcaktues midis lindjes dhe Perëndimit.<sup>486</sup>

Që të pengonte shkapërderdhjen e tyre, që do të shkonte në dëm të “*Mbretërisë së Arbërisë*” e me këtë edhe në dëm të Perëndimit dhe në dobi të Bizantit që nuk ishte më Bizant, por një krijesë që mbahej nga Sllavët, Bullgarët dhe Grekët - ndonëse luanin me Perëndimin në kurriz të tij - Karli I Anzhu, bëri një përpjekje tjetër që t’i bashkonte rreth vetes Arbrit. Në këtë kuadër liroi nga burgjet italiane një numër kryengritësish fisnikë arbërorë, mes të cilëve Gjin Muza-kën, bashkë me Dhimitër Zgurën, Kasnec e Gjuliem Blinishtin e të tjerë.<sup>487</sup>

Si do të shihet, lirimi nga internimi i këtyre fisnikëve nuk do të jetë në gjendje që ta shpëtojë Karlin I Anzhu nga rrënimi që e kishte në prag. Në Berat u vendos fati i Anzhuve, meqë ajo luftë përfundoi me një humbje të rëndë të forcave Anzhuve dhe të asaj pjese të fisnikërisë dhe bujarisë arbërore që ishin në anën e tyre. Komandanti i anzhuin, Hygo de Sully u zu rob, ndërkohë që pjesa tjetër e forcave të tij, mundi të gjente mbrojtje duke u strehuar në kështjellën e Vlorës. Kështu, Bizantinët dhe bashkë me ta edhe disa fisnikë arbërorë, ia kishin dalë që

<sup>486</sup> Shish: Camillo, Riccio: “*Geneloga di Carlo I, Anjo*”, Neapel, 1857.

<sup>487</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i parë, Tiranë 2002, faqe 244.

të ndalnin shtrirjen e “*Mbretërisë së Arbërisë*” drejt jugut me çka do të krijohen rrethanat që Mihalit VIII Paleologu të shfaqej fitues. Pse këtë nuk do ta bëjë aty për aty, kjo kishte të bënte me atë se Turqit Selxhukë kishin shpërthyer kufijtë e Perandorisë dhe kishin pushtuar Pelagoninë.<sup>488</sup>

Me gjithë kthimin e vëmendjes nga Lindja, Paleologu nuk hoqi dorë nga përkushtimi që ta rrënojë sa më shpejt që të ishte e mundur “*Mbretërinë e Arbërisë*”, e cila prej tij dhe të tjerëve shihej si një urë kapërcyese e Perëndimit drejt Kostandinopojës. Papati, që po përcillte me brengosje zhvillimet në brigjet lindore të Adriatikut, ku tashmë po zhvillohej një betejë e madhe midis Lindjes dhe Perëndimit, nuk mund të lejonte që Perëndimi të përjetonte një humbje të madhe nga Bizantit, e cila do të mund të paraqiste njëfarë hakmarrje ndaj kryqëzatës së katërt kur katolikët pushtuan Kostandinopojën dhe rrënuan shumë nga vlerat e saj kulturore. Andaj, do të angazhohet që të nisë vullnetarët katolikë nga vendet italiane, franceze, malteze e madje edhe spanjolle në mbrojtje të “*Mbretërisë së Arbërisë*”, ku në njërën anë vendosej rreth fushatës së mëtejshme të Perëndimit kah Lindja, dhe në tjetrën anë, Lindja, mund të mbrohej nga një fund i parakohshëm, që do t’i vinte në këtë mënyrë. Kështu, “*Mbretëria e Arbërisë*”, mund të kthehej në simbol të triumfit perëndimor, ose në varr të Bizantit.

Dhe meqë ishte kështu, atëherë ishte e pritshme që frymëzuesi shpirtëror i projektit, papati, me një ngjyrim tejet dramatik, t’i drejtohet Perëndimit për ndihmë. Me anën e saj, vendet katolike të Perëndimit, për herë të parë, dëgjonin për “*Mbretërinë e Arbërisë*” dhe rëndësinë që kishte ajo për interesat e kryqit perëndimor, që ishin të një natyre shumë më të gjerë se ato që motivoheshin “nga ana e kryqit” dhe përçarjet rreth tij, meqë aty shfaqej ajo pika më e ndjeshme që mund të shfrytëzohej për t’u mbrojtur kundër Osmanëve dhe depërtimit të islamit në kontinentin e vjetër, që kishte filluar të tmerronte europianët.

Thirrja dramatike që t’i vihej në ndihmë “*Mbretërisë së Arbërisë*”, shikuar nga interesat perëndimore, ishte më shumë se një ndihmë një vendi që kërcënohej, si thuhej nga “tërbimi bizantin” i Paleologëve, një pjesë e mirë e të cilit kishin qenë në anën e tij. Fjala ishte për një politikë të re të papatit të mbështetur mbi doktrinën e “universalizmit roman”, të shpallur nga Papa Nikolla III, e cila ishte mundësuar pas vdekjes së papës Grigori X (1276).

Siç dihet Papa Grigori X ishte njëri ndër ithtarët i cili i kishte mbajtur në këmbë, për aq sa lejonin rrethanat e tensionuara Lindje-Perëndim, bashkimin ro-

---

<sup>488</sup> D. Geanakoplos: “*Emperor Michael Paleologus*”, faqe 343, sipas Xhufi, Pëllumb “*Nga Paleologët te Muzakajt*”, Tiranë, 2009, faqe 132.

mano-bizantin si hallkë e fundit që do të mund ta mbronte krishterimin para pushtimi osman. Por, si do të shihet, ai nuk mund të mbahej më, meqë kjo kishte shkuar në dëm të interesave të Perëndimit, të cilat kishin filluar të sprovoheshin seriozisht te aleati i saj “*Mbretëria e Arbërisë*”, që sulmo hej nga të gjitha anët, ndërkohë që Karli I Anzhu nuk mund të vepronte jashtë konceptit të Selisë së Shenjtë, që kërkonte njëfarë “bashkërenditje” me Bizantinët, të cilët edhe më tej shiheshin si digë kundër Osmanëve. Me hipjen në fronin e papatit francez Maritin IV, kuria romane, u përcaktua që pozitën e Arbrit sovran, pra të “*Mbretërisë së Arbërisë*”, ta lidhë me “rimëkëmbjen e Perandorisë romane të uzurpuar nga Paleologët”, projekt ky që Arbërinë e ngrehte në shkallën e një misionarizmi, thuajse të ngjashëm me atë të kryqëzatave.<sup>489</sup>

Natyrisht, se një pjesë e mirë e feudalëve dhe e bujarëve arbërorë, të vetëdijshëm se Bizantit tashmë po i ikte koha dhe se mbështetja te ai do të thoshte njëherësh keqësim i pozitës së tyre kundruall Perëndimit, i cili nuk ishte përballë rrënimimit siç ndodhesh Kostandinopoja, ndihmën që do t’u vijë nga Perëndimi, në radhë të parë, do ta përjetojnë si ndihmë forcimit të tyre me anën e një kurore mbretërore, pale se ajo ishte dhe në shërbim të Anzhuve dhe ruajtjes së pranisë së tyre në këtë pjesë të botës në rivalitet të ashpër me Bizantin dhe interesat e tij. Do të shihet se feudalët dhe bujarët e Arbërisë si dhe shtresa në rritje e fisnikëve vendorë do të luftojnë sinqerisht në mbrojtje të Mbretërisë së tyre edhe atëherë kur nga sulmet e njëpasnjëshme të Bizantit, të ndihmuar nga Bullgarët, Grekët dhe veçmas Rasha, do të detyrohen të pranojnë humbjen që u erdhi nga mbarimi i vitit 1281.

Kjo humbje nuk erdh nga raportet e forcave në atë luftë, në të cilën do të mund të qëndronin edhe më tej, por nga tërheqja e pjeseshme e forcave të Karlit të Parë Anzhu nga mbrojtja e Durrësit për shkak të kthimit në Itali për të shuar një kryengritje të madhe, që kishte shpërthyer në Sicili, si pjesë e dredhisë së Bizantit, i cili, duke parë se në tokat e Arbrit, përkundër disa përçarjeve të brendshme ai ishte i pathyeshëm dhe kjo ndodhte në sajë të përcaktimit të shumicës së Arbërve që tashmë, pas shumë e shumë hezitimesh dhe përçarjesh të brendshme nga shkaku i ndodhjes në anë të ndryshme dhe të kundërta, ta mbrojnë mbretërinë e tyre, futen në lojë mbretin e Aragonës, i cili sulmoi Sicilinë dhe me këtë vulosi për të keq fatin e “*Mbretërisë së Arbërisë*” si projekt të Perëndimit, i cili ngrihej mbi faktorin arbëror dhe rolin e tij në rritje.

---

<sup>489</sup> Norden: “*Papstum und Byzanz*”, faqe 489; Nicol, D.M.: “*The Byzantine Family of Kantakouzenos 1100-1460*”, Washington, 1968; Janin, R.: “*Constantinople bizantine*”, Paris 1964.

Pas kësaj dredhie, që dobësoi forcën ushtarake të Karlit të Parë, Anzhutë nuk qenë në gjendje për të mbrojtur “*Mbretërinë e Arbërisë*”. Të kota madje qenë përpjekjet e atyre feudalëve dhe fisnikëve arbërorë për këtë, edhe përkundër faktit se shumica e tyre sinqerisht u angazhuan për të. Perandori i ri i Bizantit Androniku II Paleologu, i ndihmuar në masë të madhe nga aleatët që kishte gjetur te disa fisnikë dhe bujarë arbërorë, të cilët nuk ishin përfshirë në “*Mbretërinë e Arbërisë*”, ose që prej saj do të largohen në përputhje me lëvizjen e vijave të frontit dhe atyre që bëheshin manash për t’u arritur kjo, vazhdoi sulmet për të pushtuar qytetet e tjera të “*Mbretërisë së Arbërisë*”, duke i rikthyer dhe duke ushtruar terror të madh ndaj “tradhtarëve të ortodoksisë”, të cilët në të vërtetë, më shumë se katolicizmin i mbronin interesat e veta dhe shihnin se për herë të parë mund të shpreheshin në një shtet të vetin, qoftë ai edhe si i ardhur nga jashtë, po edhe vasal, meqë në ato rrethana, kjo ishte rrugë thujse e pashmangshme. Pas Vlorës, ra edhe Kruja dhe përfundimisht Durrësi. Më 1286 Anzhut u larguan nga vendet e Arbrit dhe ato sërish ranë nën sundimin e Bizantit të brishtë në çdo pikëpamje.<sup>490</sup>

Largimi i Anzhuve nga vendet e Arbrit pas katërmbëdhjetë vitesh sundimi dhe ndërtimi të frontit të “*Mbretërisë së Arbërisë*”, la gjurmë të thella tek Arbrit, meqë në njërin anë ishte thyer besimi i dikurshëm se Bizanti ishte themel dhe çati e tyre e vetme tek i cili duhej mbështetur, ndërsa në tjetrën anë ishte shfaqur faktori perëndimor, tek i cili mund të gjendeshin ato që në Lindje ishin humbur ose mund të humbeshin pashmangshëm. Pra, nga ajo kohë e këndej, Bizanti, ashtu si shfaqej - i lidhur për kanistrën e Rasiënëve, Grekëve, Bullgarëve dhe i paaftë për t’iu bërë ballë pushtimeve osmane - për shumë nga feudalët dhe bujarët arbërorë bëhej jo vetëm i papranueshëm, por edhe i dëmshëm. Kjo vetëdije që tashmë kishte filluar të mbizotëronte te pjesa më e madhe e tyre, bëri që Bizantinët të kundërshtohen ngado, që për pasojë pati një gjendje të turbullt, meqë ata askund nuk mund ta kthenin rendin e dikurshëm as administrativ e as kishtar, e aq më pak të kenë besimin e mbrojtësit shpirtëror. Përkundrazi, me kohë, dhe pasi që shumë prej tyre të kenë parë se nga po shkonte lumi, feudalët dhe bujarët arbërorë filluan të çojnë kokë në mbrojtje të “*Mbretërisë së Arbërisë*”, nga shkakku i vetëm se gjatë kohës së saj shumë prej tyre i shtuan dhe i forcuan pozitën shoqërore dhe politike, ndërkohë që lidhja me Perëndimin ua kishte hapur rrugën e drejtpërdrejtë të tregtisë dhe qarkullimit të mallrave në të dy anët e Adriatikut,

---

<sup>490</sup> Më gjerësisht rreth humbjes së Anzhuve shih: Shuflaj, Millan: “*Serbët dhe Shqiptarët*”, Tiranë, 2002, faqe 50; “*Historia e Popullit Shqiptar*” I, 2002, faqe 243.

gjë kjo që përpara nuk kishte ndodhur, apo edhe kur ndodhte, ishin të tjerët që shfaqeshin si ndërmjetës dhe përfitues kryesorë.

Krahas perspektivës ekonomike dhe politike që ua ofronte kthimi kah Perëndimi, që e kishin afër dhe nga toka dhe deti lidheshin me të, ndërkohë që nga një pjesë e Bizantit, ajo aziatike, që moti ishin shkëputur, ishte edhe rreziku i faktorit sllavo-ortodoks i drejtuar nga Rasha dhe dinastët e saj Nemanjajt, të cilët, nga Kryqëzata e Katërt e këndej, e kërcënonin nga të gjitha anët, gjithnjë duke ua ngushtuar hapësirën. Andaj, kthimi nga Perëndimi njëherësh do të thoshte edhe mbrojtje nga pushtimet e pareshtura rasiene, sado që edhe kjo strategji jo gjithnjë do t'u ndihmojë, ngaqë midis vendeve perëndimore, kishte të tilla që duke u lidhur me aleanca të ndryshme me ta, luanin lojëra të ndryshme me Bizantin dhe Sllavët, ndër të cilat më të shpeshtat ishin ato të Venedikut me Rashën, po edhe të hungarezëve dhe gjermanëve me ta, kishte marrëveshje të vazhdueshme, me anën e të cilave ata nxiteshin për pushtime sa më të shumta të viseve jugore.<sup>491</sup>

Sidoqoftë, përpjekjet për rikthimin e “*Mbretërisë së Arbërisë*”, ndonëse të palidhura mirë dhe jashtë ndonjë fuqie të përbashkët të drejtuar nga një qendër vendore, nuk do të shkojnë huq. Do të ketë momente kur fisnikë dhe feudalë të Arbrit do të shpallen pasues të “*Mbretërisë së Arbërisë*”, pa marrë parasysh se do t'u mungojë kurora qendrore, që e kishin sjellë Anzhut, përftimi i saj kishte shkëlqyer dhe për vite të tëra.

Por, do të jenë pikërisht Rasianët ata që morën rolin e pushtetit qendror të Bizantit që me çdo kusht të luftojnë jo vetëm “*Mbretërinë e Arbërisë*”, por edhe çfarëdo përpjekje që Arbrit do t'i çonte kah mbajtja e lidhjeve me perëndimorët. Kështu që Rasha, largimin e Anzhuve, me të cilët ata kishin pasur disa marrëveshje “përmbajtëse” në Veri, e shfrytëzoi për të pushtuar një pjesë të madhe të “*Mbretërisë së Arbërisë*”. Ata depërtuan nga Lindja dhe Verilindja prej nga e pushtuan edhe Durrësin, të cilin e mbajtën disa kohë.

Meqë despoti i Rashës, Stefan Uroshi II Milutini (1282-1321),<sup>492</sup> tashmë kishte pushtuar Shkupin dhe Prizrenin, ai kërkonte të depërtonte edhe në pjesët tjera

---

<sup>491</sup> Shih: “*Acta Albaniae Veneta*”. I nr.141-145.

<sup>492</sup> Stefan Uroshi II i njohur si Millutini (1281-1321), është i dyti në radhën e dinastisë së Nemanjajve. Titulli “*stefan*”, që e mbajnë Nemanjajt është hungarez, dhe do të thotë “princ”. Mbajtja e titullit “*stefan*” te dinastët rasiene tregon për lidhjen po dhe vasalitetin e tyre me vendet katolike, në radhë të parë me Venedikun e pastaj me Gjermanët dhe Hungarezët, që kaluan përherë nga Selia e Shenjtë dhe interesat e tyre për to, në mënyrë që me Nemanjajt të arrihte dy qëllime strategjike njëherësh: në njërën anë forcimin dhe zgjerimin e ndikimit te popullata autoktone e Ilirikut qendror (Tribalët), dhe në tjetrën anë që me forcimin e Nemanjajve të dobësonte Bizantin në pjesën më të ndjeshme, në Ilirikun Qendror. Natyrisht, se këtë strategji do ta shfrytëzojnë edhe Nemanjajt për interesat e tyre të zgjerimit të pushtetit, duke shfrytëzuar përherë favorët

në jug deri në Ohër, në mënyrë që atje, në atë trekëndësh të rëndësishëm, të përqendrohet, siç kishin bërë dikur Bullgarët. Por, Ohri do të mbrohet nga fisniku arbëror, Progon Skurra, i cili mbante titullin e lartë bizantin të *heteriarkut të madh*dhe gruaja e tij, Eudokia, ishte mbesë e perandorit të Bizantit, Androniku II Paleologu që plotësonte kushtet “formale” të jetë mëkëmbës i Bizantit në ato pjesë.<sup>493</sup>

Kjo bëri, që Rasiënët, më 1299, u tërhoqën sipër lumit Shkumbin, ndërsa Bizanti mbante Arbërinë e jugut. Ishte kjo një marrëveshje që u arrit midis Rashës dhe Bizantit, e cila u forcua me martesën e Millutinit me Simonidën, të bijën e mitur pesëvjeçare të Andronikut II. Traktati i miqësisë midis Rasiënëve dhe Bizantit ndikoi në rritjen e ndikimit të Bizantit te Rasiënët tribalë, që nisi të shprehej me zgjerime të njëpasnjëshme të territoreve që ua shkëpusnin vendeve të Arbrit.<sup>494</sup>

Se “*Mbretëria e Arbërisë*” e themeluar nga dera mbretërore e Anzhuve dhe e udhëhequr nga Karli i Parë, i cili qe shpallur “*Mbret i Arbërisë*”, pas pushtimit të saj nga Bizanti dhe despotati tribal i Rashës dhe ndarja midis saj në dy pjesë, edhe më tej do të mbetet preokupim politik dhe shtetëror i feudalëve, fisnikëve dhe bujarëve të Arbrit, këtë do ta tregojnë luftërat që gjatë tetë viteve të ardhshme zhvilluan ata kundër Bizantinëve dhe Rasiënëve, të cilët, për asnjë çast nuk ia dolën të stabilizojnë pushtimet e tyre në këto pjesë edhe kur dukej se kishin arritur fitore të caktuara ushtarake. Kjo bëri që Anzhut, por edhe papa, të mos heqin dorë nga rikthimi i “*Mbretërisë së Arbërisë*” si faktor force dhe aleat i krishterimit katolik në anën tjetër të Adriatikut, që ua hapte dyert në këtë pjesë të rëndësishme drejt Kostandinopojës. Kështu “*Mbretëria e Arbërisë*”, për Perëndimin, ishte kthyer në një fanar, ku ata varnin shpresat se një ditë mund të mbroheshin nga Osmanët. Kjo shpresë, megjithatë, vendet e Arbrit i ktheu në një log ndeshjeje dhe luftash të njëpasnjëshme, të cilat zgjatën për afër dy shekuj, që për epilog do të kenë një fitues të tretë - Osmanët.

Në këtë përpëlitje të gjatë të ndodhjes në luftën midis kryqeve, por edhe të asaj me qenë ose mos me qenë në raport me pushtimet rasiene, “*kurorën*” e Arbërisë, tashmë e kërkonin edhe feudalët dhe fisnikët arbërorë, që detyrimisht ishin

---

herë të Romës e herë të Kostandinopojës, ku kapërcimi nga njëri rit në tjetrin, do të kthehet në armë të fortë të tyre politike dhe diplomatike ndër më të fuqishmet e kohës.

<sup>493</sup> Se fisniku arbëror, *Progon Skurra*, kishte titullin e heteriarkut të madh, kjo dëshmohet nga një epigraf në kishën e Shën Klementit të Ohrit i vitit 1295.

<sup>494</sup> Ostrogorski, Georg: “*Historia e Perandorisë Bizantine*”, Tiranë 2002, faqe 348.



rrështuar kundër Bizantit, të cilët e dinin se jetësimi i “*Mbretërisë së Arbërisë*” mbronte nga hegjemonia rasiene, nga e cila mund t’i humbin të gjitha.<sup>495</sup>

Pra, këtë herë, në luftën kundër Rasieneve, Arbërorët nuk kërkonin që “kurora mbretërore” t’u zbresë nga jashtë, siç kishte ndodhur para gjashtëmbëdhjetë vjetësh kur ajo erdhi bashkë me Karlin e Parë Anzhu, pasi që të jetë shpallur në Napoli më 21 gusht 1272, por e kërkonin si fuqi të brendshme, e cila do t’i bashkonte, që gjendjen e pushtimit dhe të vasalitetit ta zëvendësonin me atë të vetëdijes mbretërore. Në sajë të kësaj lufte dhe të këtij përkushtimi, që do të zgjasë për afro tri decenie - dhe si do të shihet do ta dobësojë pushtimin bizantin dhe atë rasien në vendet e Arbrit - Filipi i Tarentit, nip i Karlit të Parë të Anzhuve zbarkoi dhe riktheu Durrësin duke u sjellë disfatë Bizantinëve. Kështu, më 1304, në Durrës do të mëkëmbet edhe një herë “*Mbretëria e Arbërisë*”, tash nga brenda dhe në bashkëpunim të plotë me faktorin arbëror, i cili ishte vetëdijesuar për rolin e fronit dhe rëndësinë e tij kur tashmë e kishte më se të qartë se kush kërkonte ta mbronte e kush ta shkatërronte deri në themel.<sup>496</sup>

Rikthimi i “*Mbretërisë së Arbërisë*”, nën drejtimin e Filipit të Tarentit, me ofiqin “*Despot i Romanisë dhe mbret i Arbërisë*”, në raport me vendësit do të paraqesë një shkallë edhe më të lartë të pavarësisë së feudalëve, fisnikëve dhe të bujarëve arbërorë, të cilët kishin luftuar që ajo të ishte në përputhje me interesat e tyre për sa më shumë pushtet të brendshëm.

Në të vërtetë kjo edhe ishte kërkuar dhe kishte paraqitur kushtin kryesor të ndërhyrjes anzhue në hapësirën arbërore. Meqë një pjesë e mirë e bujarëve arbërorë të përfshirë në territoret që kishte pushtuar Rasha (fjala ishte për ato që ndodhën gjatë kohës së despotit Millutin 1282-1321)<sup>497</sup>, si dhe atyre që gjendeshin në Bizant dhe nën despotët e Epirit, ishin gati për t’u rebeluar, në pranverën e vitit 1304, përfaqësuesit e tyre kishin mbërritur në oborrin napolitan me propozimin për një lidhje të re arbërore-anzhue. Më 5 shtator 1304 Filipi i Tarentit u drejtohet fisnikëve arbërorë të Durrësit e të Arbrit se do t’u njohë që të gjitha të drejtat dhe privilegjet që u kishte njohur gjyshe i tij, Karli I Anzhu.<sup>498</sup> Me këtë rast duhet thënë se ndër krerët arbërorë që iu bashkuan Anzhuve ishin Shpata, Bua, Zenebishti, Arianiti, Sgura, Blinishti dhe të tjerë, gjë që ai ishte mjaft i shtri-

---

<sup>495</sup> Shih: “*Acta Albaniae I, 1656.*”

<sup>496</sup> Po aty.

<sup>497</sup> Më gjerësisht rreth pushtimeve rasiene shih: Stojanović, S: „*Istorija srpskog naroda*“, Beograd 1926, faqe 141-147.

<sup>498</sup> *Acta Albaniae, I, nr. 637.*

rë, pa marrë parasysh pse aty nuk përmenden Muzakajt, të cilët edhe më tutje përpiqeshin të ruanin ekuilibrin midis dy anëve.<sup>499</sup>

Filipi i Tarentit, sapo të ripërtërijë fronin mbretëror të Arbërisë, në Durrës mbloodhi solemnisht feudalët, fisnikët dhe bujarinë për t'u ndarë atyre zotime të reja pronash dhe për t'i graduar me ofiqe të ndryshme që nuk i kishin më parë, ose që t'i rikthenin disa prej tyre që i kishin humbur gjatë kohës së Karlit të Parë Anzhu, i cili gjatë përpjekjeve të tij në luftë kundër Bizantit nuk kishte qenë në gjendje që kurdoherë të kuptonte pse disa fisnikë dhe bujarë arbërorë ndodheshin në anën e tij dhe luftonin për hesapet e Grekëve dhe të Rasianëve. Shënohet se Filipi i Tarentit, feudalin e njohur të Arbërisë, Gjuljem Blinishti, të cilin Karli I Anzhu pas disa mosmarrëveshjeve ungjin e të cilit e kishte mbajtur në internim, jo vetëm që ia kishte kthyer pronat, por e kishte emëruar mareshal i Arbërisë. Ngjashëm ishte vepruar dhe në shumë raste dhe kjo kishte kthyer besimin ndaj përfaqësuesit të Karlit të Parë.<sup>500</sup>

Thuhet se në këtë kohë Anzhuinët përhapen politikën e vet në gjithë bregdetin e Adriatikut. Bënë lidhje shumë të ngushta me autoritetet e Kroacisë dhe veçanërisht me princat e Bribirit, Shubiqët dhe me Baboniqët e Vodicës. Fituan edhe kurorën e Hungarisë. Në këto rrethana të Anzhuinët u fut edhe ideja e luftës së Kryqëzatës nëpër Ilirik për në Tokën e Shenjtë.<sup>501</sup>

Forcimi i pushtetit të Filipit në Arbëri po binte ndesh me synimet e ngjashme të despotit rasian, Uroshi II Millutini, në duart e të cilit ndodheshin disa nga tokat e Arbrit deri në Ishëm dhe, si edhe Filipi i Tarentit, përdorte titullin “*Mbret dhe kryezot i Arbërisë*”.

Edhe pse Anzhutë kishin një marrëveshje “për luftë të përbashkët kundër Bizantit”, që nga koha e Karlit I Anzhu, e cila në njëfarë mase ishte ruajtur<sup>502</sup>, megjithatë, në rrethanat e reja, Rasianët nuk ishin të interesuar për forcimin e Filipit të

---

<sup>499</sup> Po aty.

<sup>500</sup> Në një letër të 28 prillit 1311, Filipi i Tarentit, vëlla i Roberit, quhet “*Dominus Regni et Despotus Romaniae*”. (Shih *Acta Albaniae* dhe G.Monti “*Recherche sul domino angioino in Albania*”, Studio Albanesi, V-VI, 1935-6, faqe 182)

<sup>501</sup> Shuflaj, Milan: “*Serbët dhe Shqiptarët*”, Tiranë 2004, faqe 51.

<sup>502</sup> Raportet e Anzhuve me Nemanjajt njihen aty nga vitit 1250 kur Stefan Nemanja u martua me princeshën franceze, Helenën. Ishte më se e qartë se francezët, të cilët tashmë pretendonin të shtriheshin në hapësirën e Bizantit, kishin për qëllim që të bënin për vete ose të neutralizonin faktorët që do të mund ta pengonin në këtë drejtim. Ndër të rëndësishmit shfaqeshin Rasianët, me të cilët Karli I Anzhu, në vitin 1273, pasi që t'i ketë bashkuar trevat kryesore arbërore nën kurorën e Napolit me titullin e mbretit të Arbërisë (*rex Alabniae*), të lidhë aleancë edhe me despotin rasian Nemanjën, me ç'rast ai u bë garant për interesat rasiene në trevat veriore në Arbëri. Kjo aleancë do të ripërsëritet edhe në vitin 1308, kur Anzhuinët i konfirmonin Uroshit II zotimet e tyre në veri të Matit e të Ohrit. (Shih: K. Jireček: “*Historia e Serbëve*”, I Tiranë 2010; Xhufi, Pëllumb: “*Nga Paleologët te Muzakajt*”, Tiranë 2009, faqe 148-149; *Acta Albaniae*, I, nr. 589.)

Tarentit e as për rikthimin e kurorës perandorake të “*Mbretërisë së Arbërisë*”. Këtë do ta tregojnë qysh gjatë fushatës së Filipit të Tarentit në vitin 1308 për Durrësin, kur ata do të vihen në anën e Bizantinëve, me çka do t’u ndihmojnë atyre që qyteti edhe më këndeje të mbetet në duart e Bizantit.<sup>503</sup> Rasianët, edhe pasi që Durrësi do të jetë marrë nga forcat e Tarentit, do të vazhdojnë të ndihmojnë rënien e qytetit në duart të Bizantinëve, ose të tyre. Nga vitit 1312-1315, ata disa herë do të futen në të, në mënyrë që në pranverën e vitit 1318, pas një ofensive të re në jug të Matit, ata pushtuan Krujën dhe Durrësin.<sup>504</sup> Me këtë rast Uroshi II, vargut të titujve i shtoi edhe atë “*mbret i Arbërit*” (*Urossio Servie, Chelmie, Dioclieac Albanie regi*).<sup>505</sup>

Kjo gjithë çështjes i solli një domethënie të veçantë, ngaqë ndajmathja e titullit “*Mbret i Arbrit*” nga ana e Rasianëve, synonte t’ia krijonte idenë e një vazhdimësisë të kësaj me Principatën e Arbrit, i pari formacion politik arbëror që lindi aty nga mesi i shek. XII në territorin midis Matit dhe Shkumbinit,<sup>506</sup> të cilin Rasianët mund ta kishin parë si pjesë e planeve të tyre për krijimin e një “mbretërie” të përbashkët të ngjashme me atë tribale nga antikiteti, një konstrukt pajtues midis katolicizmit dhe ortodoksisë, një si urë lidhëse midis Romës dhe Kostandinopojës, që në vend të kurorës së Bizantit do të kishte atë rasiene nga Rasha tribale. Ky sheshim, fiton peshë nëse kihet parasysh fakti se do të jenë edhe despotë të tjerë nga derë e Nemanjajve që nëpër kurorat e tyre “mbretërore” që i merrnin, të shumtën nga Vatikani e herë-herë edhe nga Kostandinopoja dhe bulat kishtare nga despoti Uroshi II e deri te megazhupani Stefan Dushani “të fuqishmit” (silni),<sup>507</sup> me të cilat, në shekullin XIX, do të ndërtohen “muret” e “mbretërisë së shtetit mesjetar serb”, vazhdimisht do ta përmendin edhe Arbëninë si “*Arbëri rasiene*”.<sup>508</sup>

<sup>503</sup> Arsyet pse Rasianët nuk ishin të interesuar që sa i përket “*Mbretërisë së Arbërisë*” t’i ruanin marrëveshjet e tyre me Anzhuinët duhet kërkuar te marrëveshjet që ata lidhën me Bizantin me të cilat Nemanjajve u lejoheshin zotimet e tyre të mëtejshme që kishin Anzhotë, tashmë të rikthyera nga Bizanti, veçmas ato në bregdet. Një arsye tjetër e prishjes së marrëveshjeve me Anzhotë ishte edhe vdekja e Helenës franceze, nënës së Uroshit II në vitin 1314, që kishte shërbye si hallkë lidhëse midis francezëve dhe Rasianëve. Po në këtë kohë, Anzhotë trashëgonin fronin e Hungarisë dhe bashkë me të trashëgonin edhe armiqësinë tradicionale të fronit hungarez me Rashën. (Shih: C. Jireček: “*Albanien in der Vergangenheit*”, në “*Illyr-alb. Forschung*”, I, f. 73).

<sup>504</sup> *Acata Albaniae*, I, nr. 526, 626

<sup>505</sup> Shih: *Acta Albaniae*, I, nr. 594.

<sup>506</sup> Shih: Xhufi, Pëllumb: “*Nga Paleologët te Muzakajt*”, Tiranë, 2009, faqe 149.

<sup>507</sup> Në shumë dokumente, nofka “*Dushan*” e megazhupani Stefan Uroshi IV, është kuptuar si sinonim i fjalës serbe për “të fuqishmin” (*Dushan silni*). Duke u marrë me etimologjinë e fjalës “*Dushan*”, studiuesi i njohur Shufflyt, kundërshton qëndrimin e G. Majerit që këtë fjalë e lidh me origjinën sllave. Shufflay është i mendimit se kjo fjalë përkon me atë të shqipes “*dushman*” = i fuqishëm, dhe se këtë e dëshmon edhe ndajshtimi “i fuqishëm” që ia kanë ndajmbathur në sllavisht.

<sup>508</sup> Megazhupani Stefan Uroshi IV, me origjinë tribale, i njohur si “*Dushan*” (1331-1355), ishte ndër sundimtarët më të fuqishëm rasiandë, që përfshiu më së shumti vise arbërore në despotatin e Rashës (Rreth origjinës

Meqë despoti i Rashës, Uroshi II ishte forcuar shumë edhe me ndihmat që i vinin nga helenët bizantinë dhe Bullgarët, Filipi i Tarentit ia doli të mblidhte një koalicion europian të fuqive katolike kundër Rasianëve, ku u përfshinë Hungarezë dhe Kroatë. Papa, po ashtu, u bëri thirrje peshkopëve frëngj që kishin mbushur kishat e Arbërisë t'i ndihmonin Anzhutë. Me letra të veçanta, Papa ftoi edhe bujarët arbër që t'ia kthenin armën pushtuesit dhe të bënin çmos kundër Rashës “armikut të fesë”, siç i quante asokohe aleatët e deridjeshëm, Rasianët.

Në të vërtetë, në pranverën e vitit 1319, edhe një numër fisnikësh dhe bujarësh arbërorë nga familjet e njohura: Blinishti, Jonima, Arianiti, Matrënga, Muzaka e të tjerë, nëpërmjet peshkopit të Krujës, Andreas, i bënin thirrje papa Johanit XXII se “ishin gati të ngrinin krye dhe të hidhnin tej zgjedhën e Rashës”. Me këtë rast thuhej se do ta braktisnin ritin ortodoks dhe do ta pranonin katolicizmin, duke u ndarë edhe kishtarisht nga pushtuesit rasianë.<sup>509</sup>

Papës Johani XXII për ndihmë do t'i drejtohet personalisht Filipi i Tarentit, ku i bëhej me dije se duhej ta ndihmonte kundër Bizantinëve skizmatikë dhe sidomos kundër despotit Urosh. Ftesa e fisnikëve dhe bujarëve arbërorë si dhe ajo e Filipit të Tarentit bënë që kisha katolike e përfaqësuar nga papa i Romës, të kthehet në nxitëse dhe frymëzuese të koalicionit antirasian. Për këtë qëllim ai dërgon për organizimin e kryengritjes peshkopin e Krujës, Andrean. Krahas kësaj, me një letër të veçantë për ndihmën dhe rëndësinë e kryengritjes kundër Rasianëve, Papa do t'u drejtohet Manuel Muzakës – kont i Këlcyrës (*Comiti Clissanie*), Andre Muzakës – mareshal i Mbretërisë së Arbërisë (*regni Albanie marescalco*) dhe Teodor Muzakës – *protosebast*.<sup>510</sup>

---

tribale të Nemanjajve, pos tjerash shih: Harris, J: “*Laonikos Chalkokodyles and the Rise of the Ottoman Turks, Byzantine and Modern Greek*”, Stidues 27; Ducas “*Historia Turco-Byzantina 1341-1652*”, Bucharest, 1958; Hamer von Josef: “*Historia turskog (osmanskog) carstvar*, I, Zagreb 1979; Schreiner, P: “*Die Byzantinischen Kleinchroniken*”, I, II, III, Wien 1975-1979). Zhupani Dushan kishte nisur të fuste në dorë Epirin nga 1337-a, Arbërinë duke fillur nga 1340-a dhe Thesalinë përfundimisht më 1348. Në aktet e Republikës së Venedikut të viteve 1333 dhe 1342 ai thirret “*Stefani, me hir të Zotit, mbret i Rashës, i Dioklesë, i Hemljes, i Zentës, i Arbërisë, i një pjese të madhe të Perandorisë së Bullgarisë dhe pothuajse i gjithë Perandorisë së Roannies*”. Arsytet pse Venediku, “kurorën” e Dushanit e shihte jashtë kornizave të pushtetit të tij të njëmendë, qendrojnë te një marrëveshjen që kishin bërë me të, me të cilën, venedikasin do ta mbështesnin atë në luftë për pushtime të reja drejt jugut e deri te arritja e fronit të Konstandinopojës madje, me kusht që ato t'i ndanin për gjysmë. Hesapet e kësaj natyre kanë qenë pjesë e politikës që bënte Venediku në luftë për të ruajtur fuqinë e vet në Mesdhe dhe në Azinë e Vogël. (Më gjerësisht: ASV: *Storia documentata*, 231-232, te Plasari, Aurel: “*Skënderbeu – një histori politike*”, Tiranë 2010, faqe 122).

<sup>509</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i parë, Tiranë 2002, faqe 272.

<sup>510</sup> *Acta Albaniae*, I nr. 648; Letra është përfshirë te A.Theiner: “*Vetera Monumenta Historica Hungariam Sacram Illustrantia*, I (1216-1352), Romae, 1859, nr.1264, faqe 831. Si e tillë, letra paraqet jo vetëm një dokument të rëndësishëm të kohës, por shfaq edhe një gjendje të brendshme të rrethanave të vështira, që u janë nënshtruar të krishterët mbi të cilët ka rënduar kufiri i ndarjes së kishave nga viti 1054 e këndej, siç ishin vendet

Në korrik të vitit 1319 shënohet lufta e parë e madhe e aleatëve europianë në mbrojtje të “*Mbretërisë së Arbërisë*” kundër Rasianëve. Rasianët ia dalën t’u bëjnë ballë ushtrive të koalicionit dhe madje përkohësisht të pushtojnë edhe Durrësin, por u detyruan të largohen prej andej, ngaqë ai u mor nga katallanët e Frederikut, djalë i mbretit Frederiku III i Siqilies, që nuk zgjati shumë, ngaqë nga fillimi i vitit të ardhshëm (1320) aty prapë kthehen Anzhutë, të cilët ankoheshin në sjelljet e durrsakëve ndaj tyre.<sup>511</sup>

Edhe pse Rasianët pas pak detyrohen ta lëshojnë Durrësin, me pushtimet që vazhduan në pjesët përreth, nuk do ta lënë të qetë përderisa në Bizant plasi lufta civile midis perandorit Androniku II Paleolog dhe nipit dhe trashëgimtarit të tij, Andronikut III, që do të zgjasë shtatë vjet, me çka Anzhuve i krijohen rrethanat e përshtatshme për t’u kthyer serish në Arbëri. Bëhet e ditur se në këtë kohë mbreti Rober Anzhu kishte nisur të birin, Luigji Anzhu për në Durrës për ta rikthyer “*Mbretërinë e Arbërisë*”.<sup>512</sup>

Sipas disa burimeve të paqarta Anzhutë mbetën në Durrës edhe për një kohë. Prej andej shfrytëzuan rrethanat e përshtatshme që ua kishte krijuar lufta civile midis Paleologëve, për t’u zgjeruar edhe në jug, në despotatin e Beratit. Kjo ndodhi në vitin 1328, kur nga sulmi anzhuin u dëmtua u dëmtua rëndë, me ç’rast “u plaçkitën edhe librat e manastirit të Thelogut nga frengjit e quajtur kompanjëlë”.<sup>513</sup>

Pas tri vitesh të luftës civile, kur Bizanti në njëfarë dore ktheu paqen e brendshme, Perandoria Bizantine në shthurje e sipër, bënte përpjekje të mbi-këqyrte disa qytete, ndër të cilat Beratin, që ishte kthyer në despotat dhe të mbante të lidhur disa fisnikë arbërorë të cilëve u ndante titujt e despotëve, me të cilët u njihej pushteti vendor. Një titull i tillë i lartë iu dha Andrea I Muzakës, zot i fuqishëm i viseve mes Ohrit, Kolonjës e Beratit me ç’rast, për nga titujt, u barazua me despotët Rasianë. Të tjerë fisnikë u nderuan me titullin e lartë *sebastokrator*.<sup>514</sup>

---

e Arbnit, ku kapërcimet e pushteteve rëndom janë përcjellë edhe me ndryshimin e ritit kishtar nga ai lindor tek perëndimori dhe anasjelltas, që ka prekur edhe struktura e brendshme mbi të cilën është mbështetur kohezioni i tyre shpirtëror.

<sup>511</sup> Më gjerësisht shih te A. Kieseweter: “*I principi di Taranto e la Grecia* (1294-1373), në “Archivio Storico Pugliese”, ano LIV, fasë.I-IV gennajo-decembre 2001, f.70, shën 48 dhe te P.Xhufit “*Nga Paleologët te Muzakajt*”, Tiranë 2009, faqe 154.

<sup>512</sup> Shih *Acta Albaniae*, I, 673 ku thuhet: (*recedeat de Napoli versus pares Duracii et regni Albanie pro ipsius regni recuperatione*).

<sup>513</sup> Shih: P. Batiffol: “*Les manuscrits grecs de Berat d’Albanie*”, Paris, 1886, f.17-18.

<sup>514</sup> Xhufi, Pëllumb: “*Nga Paleologët te Muzakajt*”, Tiranë 2009, faqe 68-70.

Paqja e pashkruar e Andrinikut III me bujarët dhe fisnikët arbërorë, ku Bizanti ruante ndikimin e vet, megjithatë u prish me ardhjen në fronin e Rashës të Stefan Dushanit (1331-1355), i cili, me pushtimin e një pjese të mirë të vendeve të Arbrit, ktheu ëndrrën rasiane të Trialëve për fronin perandorak. Me këtë rast ai nënshkruan një paqe me Andronikun III Paleologun, e cila në vitin 1335 u kthye në një aleancë ushtarake midis dy palëve.<sup>515</sup>

Aleanca ushtarake midis Rashës dhe Bizantit, i dha shkas një fushate të madhe ushtarake të Bizantit që t'iu fshiheshin të gjitha gjurmët "*Mbretërisë së Arbërisë*" e me të edhe pretendimeve të Anzhuve drejt Lindjes.

Kundruall këtyre rrethanave, Perëndimi, që tashmë "*Mbretërinë e Arbërisë*" e kishte kthyer në një pararojë, kishte vënë në veprim edhe klerin katolik, që të organizonte një kryqëzatë të re europiane në mbrojtje të Arbërisë nga pushtimi rasien. Kryepeshkopi i Tivarit, Guljelm Adea, me porosi të Papa Gjoni XXII, i paraqiti më 1332 mbretit të Francës një raport, i cili më vonë i është veshur gabimisht një murgu me emrin Brokard. Sipas tij, në këtë kryqëzatë, rolin kryesor do ta luanin feudalët arbërorë, të cilët mund të nxirrin 15 mijë kalorës burra të fortë, trima dhe luftëtarë të mirë.

Në këtë letër, gjejmë edhe fjalinë e famshme që e bëri të njohur në histori rreth asaj se "*megjithëse Shqiptarët kanë një gjuhë krejt tjetër dhe të ndryshme nga Latinët, ata kanë shkronjat latine në përdorim dhe në të gjitha librat e tyre*".

Pos të tjerash në letër thuhet edhe këto:

*"Shiko, Zoti im, Mbret, ata që përmendëm më sipër (Rasianët dhe mbretërit e tyre) perandorin dhe mbretin, dhe shtëpinë e tyre, unë i përshkruaj ashtu siç është konfirmuar në të gjithë Orientin, dhe në pjesën më të madhe unë di nga eksperiencia e sigurt. Tani ai që shikon kujdesin e vëmendjes suaj, edhe mëson nëse është për t'iu besuar premtimeve, betimeve, dhe besnikërisë së të tjerëve, të cilët kanë lindur si një brez pervers dhe bij të mosbesimit të një kombi të ulët, dhe të një trangu familjar të përçudnuar, që mendojnë keq për zotin, që nuk i binden kishës, që vrasin prindërit, nuk kursejnë bijtë dhe vrasin vëllezërit etj... Për të pushtuar mbretërinë e Rashës do të ishte aq e lehtë... Sa do të mjaftonte dëshira për ta pasur një veprim të tillë. Ajo mbretëri ka pak, pothuajse asnjë vend të fortifikuar, por e tëra është me shtëpi fshati dhe kasolle, pa hendeqe mbrojtëse dhe brenda pa mure. Ndërtimet dhe godinat, si të mbretit, ashtu edhe të fisnikëve të tjerë, janë prej kashte dhe prej druri. Atje nuk mund të shohësh asgjëkund pa-*

<sup>515</sup>Joanis Contacuzeni ex imperatoria historiarum, libri IV, Venetiis, ex typogr. B. Jovarina, 1729,lib.II.cap.XXVI, f. 223-224.

*llate ose shtëpi prej guri apo prej balte veçse në qytetet bregdetare latine... Arbërit, meqë janë kombi më i madh, mund të zotërojnë në fusha luftime më shumë se 15 mijë kalorës për çdo aktivitet luftime. Janë luftëtarë trima e të shkathhtë, sipas dokeve dhe zakoneve të tyre. Dhe, meqenëse të sipërpërmendurit, si Latinët, ashtu edhe Arbrit, janë të shtypur nën zgjedhën e padurueshme dhe të rëndë të skllavërisë së atij sundimi të urryer dhe çnjerëzor: populli i shtrydhur, kleri i larguar nga pozicioni i tij dhe i poshtëruar, ipeshkvit dhe abatët, shpesh të burgosur, fisnikët të zhveshur nga trashëgimia dhe të kapur rob, kishat, si ato ipeshkvore, ashtu edhe të tjerat, të plaçkitura dhe pa të drejta, manastiret të rrënuara dhe të shkatërruara, të gjitha ose secili prej tyre do të donte të zhyste duart në gjakun e Tribalëve të sipërpërmendur, po të shikonte të shfaqej tek ata një princ francez, të cilin do ta bënin komandant në luftën e tyre kundër kriminelëve të sipërpërmendur Sllavë, armiqve të të vërtetës dhe të besimit tonë. Me të lartpërmendurit Arbër dhe latinë, 1000 kalorës francezë dhe 5000 ose 6000 këmbësorë, pa dyshim që do të pushtonin me lehtësi tërë këtë mbretëri”<sup>516</sup>*

Thirrja për këtë kryqëzatë mbeti pa jehonën e duhur, ngaqë Francezët kishin disa vështirësi me Gjermanët, ndërsa mbretëria e Sicilisë po ashtu ndodhej në konflikte të ndryshme me Spanjollët, të cilat vazhdonin ta dobësonin dhe ta pamundësonin angazhimin e saj të plotë që të forcohej për ndërhyrje të mëtejshme përtej Adriatikut dhe me këtë hapësira e Arbrit të mos mbetej pre e pushtimeve bizantine dhe atyre rasiene. Ndaj forcimit të këtyre të dytëve, që tashmë kishin pushtuar Maqedoninë dhe një pjesë të Thesalisë, si dhe rrezikut që të kthehen në fuqi kryesore në Ilirik, pra që të mos e shuanin “Mbretërinë e Arbërisë” siç do të veprojnë Dushani pak më vonë, mbreti Rober i Anzhuve, sapo të vijë në fron, më 1333, emëroi të birin kapiten të Durrësit dhe në luftë kundër Rasiëve i mbështeti shpresat te feudalët arbëreshë.

Në përpjekjet e mbrojtjes së “Mbretërisë së Arbërisë” kundër Dushanit, dy nga feudalët arbërorë patën rëndësi të madhe: Tanush Thopia, i cili kishte pronat midis Durrësit dhe Tiranës dhe Andrea Muzaka, pronat e të cilit ndodheshin midis lumenjve Shkumbin dhe Seman.<sup>517</sup>

Djali tjetër i mbretit Rober, Ludoviku në vitin 1336, me një ushtri të konsiderueshme zbarkoi në Durrës dhe bëri marrëveshje me Andrea Muzakën. Muzakës iu njoh titulli i “Despotit të Arbërisë”. Përpjekjet për t’i afruar sa më shumë feudalët arbërorë me prona dhe tituj të ndryshëm, vazhdoi edhe më tutje, meqë

<sup>516</sup> “Ekskluzive”, Prishtinë, nr. 28 gusht 2002.

<sup>517</sup> Po aty, faqe 192.

ishte më se e qartë se “*Mbretëria e Arbërisë*” mund të kishte sukses në luftë kundër pushtimeve sllave, vetëm nëse ajo mbështetej nga faktori i brendshëm dhe ata e shihnin si interes të tyre.

Në këtë rrugë, do të përfitohet edhe Tanush Thopia. Edhe Thopisë do t’i njihet titulli i “*Kontit të Arbërisë*” dhe do t’i jepen prona të tjera midis lumenjve Mat e Shkumbin me ç’rast u njoh edhe principata e tij në këto hapësira. Thopia do të marrë edhe 1000 grosh në vit nga të ardhurat e kripores së Durrësit.<sup>518</sup>

Me titullin e “*Kontit të Arbërisë*”, Thopia, si vasal i Anzhuve, mbajti Durrësin edhe për 22 vitet e ardhshme. Më pas, Durrësi herë pas herë kthehet në log të sulmeve dhe kundërsulmeve të ndryshme, ku do të ruhet pushteti i anzhuve, i cili do të zgjatë deri në vitin 1382. Në fillim të këtij viti, Balsha II, sundimtarë i Zetës dhe i Vlorës, pushtoi Durrësin. E mbajti deri në vitin 1385, kur në betejën e Savrës, bashkë me kokën do ta humbë nga Karl Thopia.<sup>519</sup>

Përkundër përfshirjes së feudalëve Arbër në postet kryesore të “*Mbretërisë së Arbërisë*”, kuptohet, si vasalë të mbretit Anzhu - dhe kjo as që mund të ishte ndryshe në ato rrethana - këto masa nuk i penguan Stefan Dushanit rrugën e pushtimit të Arbërisë. Më 1343 pushtoi Krujën. Dy vjet më vonë Beratit dhe më 1347 pushtoi Vlorën dhe Kaninën. Por, për t’u bërë “perandor”, siç kishte paralajmëruar, dhe me këtë për të fituar të drejtën që të trashëgojë Bizantin, Dushanit i duhej pëlqimi edhe i tjetrit krah, pra i Perëndimit, me të cilin ai vazhdimisht ishte në lidhje dhe aleanca, siç kishin vepruar edhe paraardhësit e tij, Nemanjasit nga koha e Dioklesë në shekullin XI e deri te Rasha në shekullin XIII kur do të vendosen atje me ndihmën e Vatikanit dhe të Hungarezëve.

Ky “krah” perëndimor ishte Venediku, i cili po ashtu kishte hesapet e veta me Dushanin për ta dobësuar Kostandinopojën duke shtuar ndikimin e vet në pjesët qendrore dhe perëndimore të Ilirikut. Tek e fundit, Dushani dhe familja e tij prej vitesh ishin qytetarë të Venedikut, të cilit vazhdimisht i drejtohej për ndihmë dhe lidhje sa më të afërta. Këto lidhje u vendosen në vitin 1340 kur ai mori zotimin se, në rast nevoje, Venedikut do t’i dërgonte edhe ushtarë (deri në 500 kalorës) të cilëve do t’u prijë vetë. Me këtë rast Venediku atij dhe familjes së tij i dha të drejtën e qytetarisë veneciane. Andaj, si qytetar venedikas, në janar të vitit 1346, nga Raguza, Dushani dërgoi një delegacion në Venedik për të bërë të ditur

---

<sup>518</sup> Me marrëveshjen me Ludovikun në vitin 1338 Tanush Thopisë iu njoh principata e tij ndërmjet Matit dhe Shkumbinit që e kishte nga Papa i Romës: “*et insuper confirmamus eidem comitatum a Maet usque Scampinum, donatum eidem comiti ut ronitur per dominum summum pontificem*” (Shih te Shuflaj “*Serbët dhe Shqiptarët*”, Tiranë 2004, faqe 53.)

<sup>519</sup> Shih: Shuflaj, Milan: “*Serbët dhe Shqiptarët*”, Tiranë 2004, faqe 56.



kurorëzimin e ardhshëm të mbretit (*coronatio sua in imperio Constantinopolitano*) me ç'rast kërkoi një aleancë për pushtimin e kësaj Perandorie.

Natyrisht se për Venedikun, çfarëdo aleance e tillë ishte e papranueshme, meqë kjo e fuste në një aventurë që nuk mund t'ia lejonte vetes. Sepse, si dihet Venediku kishte strategjinë e njohur, të tjetër t'i fuste në luftë, ndërsa përfitimet t'i nxirrte vetë. Në këtë situatë venedikasit ishin më të kënaqur me pushtimet e Dushanit dhe shtrirjen e tij në drejtim të Lindjes, andaj atij iu përgjigjën me urime të përzemërta. Pas këtij përgëzimi, Dushani vendosi që të kurorëzohej "perandor" në të dielën e pashkëve, më 16 prill 1346 në një kuvend në Scup (Shkup) nga patriarku ortodoks Joanikij dhe patriarku bullgar, Simeon i Tërnovit. Mbretëresha Helenë u kurorëzua perandoreshë, ndërsa djali Uroshi - mbret, me çka megazhupani tribal i Rashës ia kishte dalë që t'i bënte për vete faktorët kryesorë rajonalë për të arritur aty ku ëndërronte.<sup>520</sup>

Pos pjesëve që dikur i takonin hapësirës së Dardanisë së Justinianit, që Dushani e ka pasur shëmbëllesë dhe jo rastësisht në gërmadhat e Justiniana Primës (në afërsi të Skupit) do ta bëjë kurorëzimin kishtar, "perandori" i vetëshpallur vazhdoi pushtimet e tij kah jugu, pra që "Perandorisë" t'ia shtonte edhe Epirin dhe viset e tjera deri në Jug të Greqisë, në mënyrë që atje ta përfundonte ëndrrën e tij për t'u bërë "perandor" i madh. Në këtë rrugë Dushani kishte edhe fat ngaqë i shkoi për shtati edhe murtaja e vitit 1348, e cila në Europë u hap nga Mbretëria e Tartarëve. Në kohën kur murtaja kishte shkretuar shumë pjesë të Ilirikut qendror dhe lindor, Dushanit vazhdonte fushatën pushtuese. Madje, kjo edhe i ndihmoi, meqë e paktë ishte rezistenca që haste.<sup>521</sup>

Në këto rrethana Dushani, pra kur përpara kishte më shumë të sëmurë se kundërshtarë, u fut në Epir dhe pushtoi Janinën, Artën dhe qytetet e tjera deri në kufijtë e Frankëve - Anzhuve, në atë kohë, sundues të Butrintit dhe të Lepantosit, Brienës, të dukëve të dikurshëm të Athinës.

Bëhet e ditur se Arbit, të cilët ishin armiqësuar me Grekët në kohën e Andronikut III, iu bashkuan Dushanit. Në këtë mënyrë ia dolën të ruajnë tokat dhe pasurinë e tyre, e cila kohë më parë ishte rrezikuar nga Bizantinët.<sup>522</sup>

Meqë nuk shihte ndonjë rrezik nga Bizanti i përçarë dhe i dobësuar edhe nga luftërat e brendshme për pushtet midis Paleologëve (të cilët mbështeteshin prej

---

<sup>520</sup> Ostrogroski, Georg: "Historia e Perandorisë Bizantine", Tiranë 2010, faqe 428 dhe Miklosich, F: "Monumenta Serbica, Bosnae, Ragusii", Wien, 1858.

<sup>521</sup> Dil, Sharl: "Istorija vizantijskog carstva", 1919, faqe 97.

<sup>522</sup> Shih: Katakuzenos IV, kap 20.

tij) dhe Katankuzenit, që mbështetej nga Gjenova dhe Hungaria dhe, që të evitonte çfarëdo rreziku të “frankëve” pra Anzhuve, të cilët mund të shfaqeshin prapë në anën e fisnikëve dhe bujarëve të Arbrit (pasi në kujtesën e tyre “*Mbretëria e Arbërisë*”, e kohës së Karlit dhe të Filipit të Tarentit, si një krijesë perëndimore, sa vinte e fiksohej si zhdëmtim për Bizantin që po tretej), Dushani prapë iu kthye lidhjeve të mira me Venedikun. Ia ofroi disa nga pushtimet në këtë pjesë si dhe përkrahje të plotë nëse ata vendosnin që ta pushtonin Kostandinopojën. Venediku, i cili kishte nevojë për Dushanin në luftën e pritur kundër Hungarisë dhe Gjenovës, që do të shpërthente së shpejti, e përgëzoi atë dhe i fali prona të tjera në Venedik. Madje, që kjo përkrahje të dukej sa më solemne, Venediku dërgoi në Rashë një delegacion të madh venedikas dhe raguzian me në krye kontin Nikola Girogi nga Bodanica.<sup>523</sup>

Lidhjet me Venedikun dhe përpjekjet e tij që të përfitonte sa më shumë prej tyre, megjithatë Dushanit nuk do t’i ndihmojnë gjithaq që të jetë i qetë nga aleanca e Hungarisë me Gjenovën. Si do të shihet, hungarezët, të cilët pretendonin Bosnjën, Kroacinë dhe bregdetin Adriatik, më kohë do të fitojnë gjithnjë e më shumë peshë. Meqë rreziku turk bëhej gjithnjë e më i madh, ndërsa Katankuzeni shihej i lidhur gjithnjë e më shumë me ta për të rikthyer pushtetin e humbur dhe për ta fituar garën me Paleologun, Dushani do të trimërohet nga Selia e Shenjtë që të hyjë në luftë me Turqit qoftë edhe me çmimin që ta pushtonte fronin e Bizantit në Kostandinopojë.<sup>524</sup>

Ai kishte edhe mbështetjen e Gjermanëve për këtë punë. Por, do të jetë një luftë thuajse e papritur që shpërtheu midis Ludvigut të Hungarisë dhe Dushanit që atë e pengoi jo vetëm ta merrte flamurin e një kryqëzate perëndimore kundër turqve, siç shpresonte Roma, po ta kthente te përmasat reale të forcës që kishte, pra të një humbësi të pashmangshëm. Kështu, pas një viti, Dushanit me të shpejtë do t’i shembej “kulla” që e kishte ngritur më shumë në saje të faktorëve të jashtëm (dobësimit të brendshëm të Bizantit si dhe planeve të Venedikut dhe Selisë së Shenjtë për ta rrënuar përgjithmonë meqë në atë grahmë nuk ishte në gjendje të kthehet në një bastion ndaj pushtimeve turke që po i afroreshin Europës), se sa të forcës së brendshme.<sup>525</sup>

---

<sup>523</sup> Shih: Jiriček, Konstandin: “*Historia e Serbëve*“, I, Tiranë 2010, faqe 449-451.

<sup>524</sup> Trimërimet që Dushanit i vinin nga Selia e Shenjtë dëshmohen më së miri nga një *brevë* që Kryepeshkopët e Tivarit e merrnin nga Papa, e cila fillonte me formulën lavdëruese për “mbretërinë” e Rashës: “*Carissimo in Christo filio nostro regi Rassie illustri*” te Plasari, Aurel: “*Skënderbeu*”, Tiranë 2010, faqe 94.

<sup>525</sup> Jiriček, Konstandin: “*Historia e Serbëve*“, Tiranë 2010 faqe 451.

Sidoqoftë, në verën e vitit 1354, Ludvigu u fut në Beograd, ndërkohë që Dushani i rraskapitur me “kurorën e perandorit” të vetëshpallur dhe të shkallmuar, që kishte filluar t’ia rëndonte kokën, kthehet në jug, në manastirin e Rudnikut. Gjatë atij dimri dhe pranvere, Dushani nuk u lirua dot nga ankthi hungarez, edhe pse venedikasit do të ndërhyjnë që të nxjerrin një paqe midis tyre, nga shkakku se kishin frikë nga forcimi i mëtutjeshëm i Hungarezëve. Por, as ajo ndërhyrje nuk ia ndërpreu rënien e vërtetë “perandorit” tribal të Rashës, meqë ai në dhjetorin e atij viti, pra ditën e njëzet të muajit të fundit të vitit 1355, vdiq diku afër Nerodimes dhe varroset në Prizren, në manastirin e Kryengjëllit, që e kishte rindërtuar.<sup>526</sup>

Edhe pse përfundoi aty ku kishte menduar se duhej të merrte fuqi “shpirtërore”, ndërkohë që ëndrra për t’u bërë perandor i Bizantit, do t’i kthehej në makth ngrehinës së tij të përkohshme, e cila me të shpejtë do të shprishet, pra edhe përkundër këtyre disfatave, Rasha e Dushanit tribal, në një luftë të gjatë kundër Arbërve dhe hapësirës së tyre, synonte disa qëllime strategjike me pasoja edhe për zhvillimet e mëtejshme dhe rrethanat nëpër të cilat do të kalojë Iliriku dhe Europa Juglindore në përgjithësi gjatë pesë shekujve të ardhshëm. Ndër këto qëllime strategjik synohej:

-Të rrënohet çfarëdo bërthame shtetërore e Arbërve, që ata do t’i lidhte me Bizantin. Në shënjestër të tyre u vunë fisnikët dhe bujarët si dhe zotimet e tyre prej nga ata mund të faktorizoheshin në kuadër të Perandorisë për t’u kthyer në mbështetës të saj. Me këtë rast kihej parasysh “*Despotati i Epirit*” dhe roli që kishte luajtur nga Kryqëzata e Dytë e këndej;

-Të rrënohet çfarëdo bërthame që do të mundësonte rishfaqjen e “*Mbretërisë së Arbërisë*”, të ngjashme me atë të Anzhuve apo ndonjë tjetër, që do të ishte fryt i përpjekjeve të përbashkëta të Perëndimit katolik dhe i feudalëve, fisnikëve dhe i bujarisë arbërore në ngritje e sipër për ta siguruar një përkrahës të tyre këndej Adriatikut, pikërisht aty ku fillonte kufiri i ndarjes, dhe

- Dhe, në saje të kësaj lufte dhe fitoreje kundër Arbërve, despotati i Dushanit, i mbështetur në kujtesën historike të mbretërisë Tribale, të forcohej sa më shumë që të ishte e mundur në mënyrë që si i tillë të luftonte për ta zëvendësuar Bizantin, i cili tashmë ndodhej në një gjendje të shthurjes së plotë dhe, përballë depërtimeve Osmane, shfaqte një rrezik, që për t’u mbajtur dosido

---

<sup>526</sup> Shih: Orbin, faqe 268 shkruan se Stevan Dushani ka vdekur nga ethët në Nerodime, ndonëse ky kronist nuk është kredibil, gjë që edhe kjo e dhënë duhet marrë me rezervë ngaqë mund të jetë e sajuar.

në pushtet, kishte filluar të lidhte aleanca edhe me osmanet në dëm të Perëndimit katolik.

Dushani e dinte se Papati dhe vendet tjera europiane, për ta parandaluar këtë zhvillim, që në disa forma kishte filluar të jetësohej, ishin në gjendje që tribalit rasian t'ia dhuronin qoftë edhe kurorën e Bizantit. Të kësaj kohe janë edhe përpjekjet e Dushanit që t'i afrohej sa më shumë Perëndimit (Venedikut dhe Selisë së Shenjtë), edhe pse është e njohur fushata e tij kundër katolikëve, e cila do të marrë përmasa shqetësuese, saqë një numër fisnikësh arbërorë t'i kërkojnë Papës që të merrte masa mbrojtëse. I njohur është njëfarë letërkëmbimi midis Dushanit dhe Selisë së Shenjtë, ku ai kërkon falje për "keqkuptimet",<sup>527</sup> që pak më vonë jo vetëm që do t'i quajë "të pavenda", por siç del nga një letër, Papës Inocentit V në vitin 1354, ai bën të ditur se menjëherë do t'u kthehen të gjitha pronat kishave latine dhe do t'u jepet mundësi që priftërinjtë e larguar të kthehen dhe të punojnë lirshëm. Me këtë rast, Dushani, Papën e quante "baba të krishterimit, përfaqësues të së vërtetës së Krishtit dhe pasardhës të Shën Pjetrit".<sup>528</sup>

Ndryshe nga Bizanti, që sipas nevojës, në shumë raste respektonte feudalët, fisnikët dhe bujarët arbërorë dhe mendohej t'i mbante në shërbim gjithnjë duke u përpjekur që fuqinë e tyre, në forma të qeverisjeve të brendshme vendore me kompetenca të caktuara (themat, bujaritë e deri te principatat), ta mbante të lidhur për vete, Dushani bëri të kundërtën, madje edhe atëherë kur gjatë kremteve dhe promovimeve të kurorës së tij, nëpër karta që shpallte, siç vepronin edhe paraardhësit e tij nga Uroshi II e këndej, vazhdimisht ia shtonte edhe atributin "*Mbret i arbanasve*".<sup>529</sup>

Kjo tregon se ai, si tribal kishte parasysh forcën e faktorit arbëror dhe lidhjet nga lashtësia me të, të cilën dëshironte ta mbikëqyrte dhe ta përdorte për qëllimet e veta, por pa lejuar që me asgjë të faktorizohej. Kështu, në përputhje me këtë qëndrim, edhe atëherë kur zotohej solemnisht se respektonte feudalët vendorë dhe besnikëve u premtonte dhe në disa raste madje edhe u jepte edhe më shumë seç kishin (prona ose tituj zhupanë, vojvodë etj.), megjithatë, nëpër vendet e Arb-

---

<sup>527</sup> Më gjerësisht shih: Gjini, Gaspër: "*Skopsko-prizrenska biskupija kroz stoljeća*", Zagreb 1986, faqe 100-114.

<sup>528</sup> Shih letrën që Dushani ia dërgon papës Inocentit V në vitin 1354, ku ai i kërkon falje dhe kërkon që t'i nënshtrohet në plotni Selisë së Shenjtë. Në letrën që Papa ia kthen Dushanit, përgëzohet për kthesën e tij dhe i premtohet përkahje e gjithanshme. Me këtë rast Papa Dushanin e quan "*Rex Rasie*" - *Mbret i Rashës*, titull kishtar që Selia e Shenjtë e përdorte për feudalët dhe despotët autonomë në pjesën e Bizantit, që duhej të fuqizoheshin për t'u dobësuar Bizanti, por që mbetej jashtë ndonjë ingerence shtetërore, siç shihet në shekullin XIX nga historianët serbë, të cilët, mbi bulat kishtarë, të shumtën të rishkruara e të falsifikuara në Hilandar, Troshan e deri në Karlovc,projektojnë edhe historitë politike jashtë realiteteve historike. (Jiriček, Konstandin: "*Historia e Serbëve*", Tiranë 2010, faqe 449.)

<sup>529</sup> Shih: *Acta Albaniae I*, nr 594.

nit, aty ku futej ushtria e tij me vete kishte edhe sundimtarët e vet që vendoseshin si administratorë fuqiplotë.<sup>530</sup>

Kjo mënyrë e sundimit, në përputhje me logjikën e më të fortit, që karakterizonte edhe raporte midis fiseve ilire-thrakase në antikitet (Dardanëve, Tribalëve, Maqedonasve dhe të tjerëve) dhe luftërat e tyre të brendshme, u përcoll edhe me masat që nga ana e tij merreshin për forcimin e kishës ortodokse, që bazuar në bulat kishtare, që ndonëse duhet marrë me rezervë, ngaqë shumë prej tyre janë falsifikuar në shekullin XIX që të krijohet një pasqyrë e rreme për qëllime politike,<sup>531</sup> do t'u dhurohen prona të mëdha dhe katunde të tëra arbërore.<sup>532</sup>

Ajo që do të bjerë në sy gjatë sundimit të Dushanit në vendet e Arbrit, është se ai bëri përpjekje të mëdha që pjesa më vitale, Dardania antike dhe Maqedonia të kthehen në “bërthamë” institucionale dhe shpirtërore. Kështu kishin bërë dikur edhe Bullgarët, veçmas në kohën e mbretit Simeon, me ç’rast, qendra kryesore e zhupanisë rasiene, qoftë përkohësisht, u bënë Prizreni dhe Scupi (Shkupi), ku vendosi institucionet kishtare. Edhe historiografia nacionaliste sere mundohet që këto veprime që vinë nga dokumentet e sajuara kishtare t’i kthejë në “kapital shtetëro” megjithatë koha e pushtimit jo gjithaq të gjatë të Dushanit (prej nëntë vitesh), nuk i jep të drejtë një qëndrimi të tillë, veçmas kur dihet se edhe në këto rrethana që quhen “armiqësore” me katolikët, Dushani ruajti lidhjet e veçanta me Vatikanin.

Sidoqoftë, e vërteta e fshehur e lidhjeve të Dushanit me Vatikanin asokohe, nuk mohon faktin prirjet e vazhdueshme të kishës ortodokse, për të identifikuar vetëdijen kishtare me atë etnike, me ç’rast kjo e para, pra kishtarja, përcaktonte të dytën, prej nga do ta ketë burimin manipulimi i përkatësisë fetare me atë kombëtare në shekullin XIX te Grekët dhe serbët, pa marrë parasysh se ortodoksë kishte edhe te Rusët, Rumunët, Shqiptarët dhe të tjerët.<sup>533</sup>

Edhe para se të vijë Dushani në pushtet dhe Rasha të shtrijë pushtimet në viset e Arbrit (në Dardani dhe Maqedoni), shfaqet lufta e hapur e kishës ortodokse dhe e pushtuesve rasiene kundër besimtarëve katolikë të vendeve të Arbrit, që

---

<sup>530</sup> Shih: Rexha, Enver: *“Historiografia serbe për Kosovën (XIII-XIX)”*, Prishtinë 2009, faqe 11-115.

<sup>531</sup> Shih: Šekularac, Božidar: *“Dukljansko-zetske povleje”*, Titograd 1987, faqe 43; Ivanović, R.: *„Dečansko vlastelinstvo“*, Beograd, 1954.

<sup>532</sup> Më gjerësisht rreth pronave të Arbërve që iu dhuruan kishave ortodokse (asaj të Deçanit, të Prizrenit, por edhe të Hilandarit në Malin e Shenjtë në Greqi, shih: Miloš, Milojević: *“Dečanske hristovulje”*, Beograd, 1880; Novaković, St.: *“Zakonski spomenici srpskih država srednjeg veka”*, Beograd, 1912; Solovjev, Aleksandar: *“Odabrani spomenici srpskog prava srednjeg veka”*, Beograd, 1912; Ivanović, R.: *“Dečansko vlastelinstvo”*, Beograd, 1954.

<sup>533</sup> Shih: Gjini, Gaspër *“Skopsko-prizrenska biskupija kroz stoljeća”*, Zagreb 1986, faqe 79-86.

nuk mund të shpjegohet ndryshe pos si strategji e matur mirë me qëllim të dyfishtë: në njërën anë që të pengohen Arbrit të ruajnë përkatësinë e kishës perëndimore, që e kishin një pjesë e tyre por si pakicë, e me këto prirjet e tyre perëndimore, dhe në tjetrën anë që t'i ndihmojnë kishës lindore që të ruajë mbikëqyrjen në këtë pjesë të rëndësishme të botës, ku bizantinizmi në tërësi ishte identifikuar me dominimin sllav.

Është me interes të thuhet se burimet kishtarë bëjnë të ditur se para se Rasha të fillonte fushatën kundër “herezisë”, siç ndodhi gjatë kohës së Dushanit, zhupania e Rashës e drejtuar nga Nemanjasit, fillimisht i kishte takuar ritit katolik, lidhje kjo që do të mbahet edhe më tutje. Madje, Stefani i Nemanjëve, kishte letërkëmbim me Papën Inocentini III dhe e quante “*at shpirtëror*”.<sup>534</sup>

Ndaj, nuk ishte e rastit, që në vitin 1217 Stefan Nemanja, nga Papa Inocenti III fitoi kurorën. Atë ia dorëzoi legati i tij i posaçëm, një “peshkop i Albanit”<sup>535</sup>.

Në letrën që Stefani ia ktheu Papës pos të tjerash thuhet “*se ndjehet bir i kishës romake*”, me ç’rast papës ia dërgon besimin dhe i betohej se “*dëshironte t’u ishte besnik mësimëve të kësaj mëme të shenjtë*”.<sup>536</sup>

Lidhjet e mira midis Vatikanit dhe Rashës, në vitin 1307, përjetuan një ashpërsim disavjeçar, çastin që Millutini (Stefan Uroshi II) do t’i drejtohet Papës Klementi V që si kundërshtpërbllim për pranimin e unisë, siç kishte vepruar edhe i vëllai, të ndërmjetësojë te Karl Valoisi, pretendenti për perandor të Perandorisë Perëndimore, që t’i fitojë disa toka dhe qytete të Bizantit, të cilat shtriheshin në Maqedoni,<sup>537</sup> që ndonëse do t’i premtohen nga përfaqësuesi i Romës, ai do të heqë dorë nga marrëveshja me arsyetimin “*nga frika nga klerikët e fuqishëm ortodoks*”.<sup>538</sup>

Përkundër lajkave të njohura të despotëve Rasianë që bënë me njërën apo me tjetrën kishë për përfitime, lidhjet e tyre me Selinë e Shenjtë nuk u ndërprejnë asnjëherë edhe kur kishte ndonjë ashpërsim. Si të tilla ato u konfirmuan edhe nga vetë Stefan Dushani në kulmin e fuqisë së tij, kur Papën Inocenti V e quajti përfaqësues të Krishtit dhe kërkoi bekimin e tij në luftë kundër Osmanëve. Edhe pse kisha ortodokse Nemanjajt, me përjashtim të Dushanit, që të gjithë i shpalli të

---

<sup>534</sup> Theimer, A: “*Monumenta Slavorum*” I, 6 nr. 11.

<sup>535</sup> Gjin Gasperit “*Skopsoko Prizrenska biskupija kroz stoljeća*”, faqe 88.

<sup>536</sup> Po aty, faqe 88.

<sup>537</sup> Shih Purković M: “*Avinjonske pape i srpske zemlje*”, Pozharevac, 1934; pastaj Novaković St. “*Nemanjičke prestonice Ras-Pauni-Nerodimlje*”, botuar në SANU 88 (1911) nr. 14; Radonić dr Jovan: “*Vizantija i rimokatolička crkva u prvoj polovini XV veka*”, Beograd 1905.

<sup>538</sup> Plasari, Aurel: “*Skënderbeu*”, Tiranë 2010, faqe 90.

shenjtë dhe ata kremtohen si të tillë, kjo nuk e mohon faktin se ata mbeten përherë të lidhur me kishën katolike.

Arsyetimet si ato te Stefan Urshit II se hiqte dorë nga marrëveshjet si thuhej nga *“frika nga klerikët e fuqishëm ortodoks”*, kanë të bëjnë me disa lidhje të tjera të Rashës me princat Grekë, me të cilat ajo siguronte një shtrirje në Thesali në dobi të një aleance me Grekët dhe të forcimit të boshtit midis tyre në dëm të Bullgarëve, por që nuk kanë qenë asnjëherë të sinqerta, sepse Rasianët ndërronin aleatët në përputhje me rrethanat, gjë që do ta hetojnë edhe Grekët, të cilët nuk do të kursehen gjatë pushtimeve të Dushanit. Madje ai do të tregohet mospërfillës ndaj gjuhës dhe kishës greke, siç do të tregohet mospërfillës edhe ndaj Bizantit në përgjithësi, të cilit do të mundohet t’ia marrë fronin, duke kërkuar që këtë ta bëjë në aleancë me Venedikun dhe forcat e tjera perëndimore, pa përjashtuar këtu edhe Selinë e Shenjtë, ndonëse ia ndiqte besimtarët në tokat e pushtuara. Sidoqoftë, Uroshi II filloi fushatën e ashpër kundër katolikëve, së pari duke ndaluar gjuhën latine nga liturgjia dhe më vonë duke ndaluar edhe hapjen e manastireve katolike në Trepçë, Novobërdë dhe në disa vende të tjera, që parashihte një marrëveshje e vonshme me Selinë e Shenjtë, por që e gjitha shkakun e kishte te rivaliteti midis peshkopatës së Tivarit dhe të Kotorit për të administruar kishat katolike në pjesën që sundoheshin nga Nemanjajt. Meqë, Papa Inopenti III, në këtë garë e kishte vendosur në dobi të Tivarit, Nemanjasit, këtë vendim nuk do ta presin mirë, meqë kishin disa konflikte me administratorët kishtarë të Tivarit. Kjo do të pasqyrohet edhe në sjelljen jo të mirë ndaj klerikëve katolikë në këto pjesë, që ishte e natyrshme dramatizimi nga ana e tyre.<sup>539</sup>

Ata që u gjenden në shënjestër të këtyre masave ishte e pritshme të kundërshtojnë. Kjo dëshmohet kur një delegacion i krerëve të fisnikëve arbërorë, të lidhur me kishën katolike, në pranverën e vitit 1319, dërguan përfaqësuesit e tyre tek Papa Gjoni XXII në Avinjon, me ç’rast bënë me dije për telashet që besimtarët katolikë dhe kisha e tyre në ato rrethana. Po ashtu, ata kërkuan nga Papa leje që, nëse Rasianët nuk ndryshojnë sjelljen, të organizojë një kryengritje, e cila do të ndihmohej edhe nga vullnetarë nga vendet katolike.<sup>540</sup>

---

<sup>539</sup> Theimer, A: *“Monumenta Slavorum”*, I, 6 nr. 12.

<sup>540</sup> Shih Gasper Gjini: *“Skopsko Prizrenska biskupija kroz stoljeća”*, faqe 90. Aty, pos të tjerash, jepen edhe hollësi të përfaqësuesve të Shqiptarëve, të cilët të shumtën ishin nga Prizreni dhe udhëhiqeshin nga fisniku i njohur Mentulus Musatius. Bëhet e ditur se papa i kishte pritur mirë dhe u kishte premtuar ndihmë të gjithanshme, por me këshillën që të mos i hynin ndonjë rebelimi para se të shtroheshin që të gjitha bisedimet me Rashën.

Kjo gjendje, duket se do të ndryshojë, pasi që Papa Klementi V, do të vendosë që mbikëqyrjen administrative të katolikëve në Rashë e deri në Beograd t'ia besojë kishës së Kotorrit. Në vitin 1346, papa Klementi V i shkroi një letër Dushanit, në të cilën e njoftonte për qëndrimin e tij rreth kompetencave të kishës së Kotorrit, me ç'ka Dushani, duke ia bërë me dije se *“ato që i thuheshin ishin vetëm shpifje të misionarëve të papërgjegjshëm, dhe se ai, kishte ndërmend që të hapte edhe më këndeje manastire për besimtarët katolikë, të cilët i respektonte”*<sup>541</sup>.

Tivari, megjithatë, do t'ia dalë që të rikthejë betejën “e humbur” me Kotorin rreth primatit ndaj katolikëve në Rashë dhe Dardani, gjatë kohës së Gjuragj Brankoviqit, në vitin 1456 me anën e një marrëveshje me ç'rast peshkopi i Kotorit mernte titullin: *“Primas Regni Serviae”* (i pari i krahinës së Serbisë), pra titull kishtar, që historiografia serbe e përktheu në atë shtetëror, pra “mbretëri serbe”!<sup>542</sup>

## AGONIA E BIZANTIT DHE PRINCIPATAT E ARBRIT

Vdekja e papritur e Stefan Dushanit, më 20 dhjetor 1355, hapi faqen e fundit të agonisë së Bizantit, që ndonëse do të vazhdojë edhe për një shekull të tërë, për deri sa kështjella e fundit, Kostandinopoja ra në duar të Osmanëve, krijoi një rrëmujë të madhe në Ilirik dhe tutje, ku asaj i kishin mbetur disa “oaze”, siç ishte Moreja dhe disa despotë thuajse të pavarur arbër dhe helenë-bizantinë në Epir dhe Thesali, të cilët me të shpejtë shpallën pretendimet e tyre për t'u pavarësuar. Kjo rrëmujë u bë edhe më e madhe pasi që as Paleologët e as Katankuzenët, që “bashkëqeverisnin” Bizantin të shumtën duke u grindur dhe në dëm të pjesës që i kishte mbetur, nuk ishin në gjendje që të mbikëqyrnin atë.

Edhe para se të shkaktonte kjo krizë, Bizanti ishte aq i katandisur dhe çështje ishte se kujt do t'i shkonin copëzat e fundit të Perandorisë: Osmanëve apo një fuqie tjetër të krishterë, e cila do të ishte në gjendje që ta mbante kurorën e Lindjes?

Meqë Osmanët tashmë ia kishin dalë që të pushtonin të gjitha qytetet kryesore të Azisë së Vogël dhe me “shëtitjet” e tyre në Mesdhe dhe Adriatik nga të gjitha anët ia kishin vënë pritat presë së tyre, përballë këtij shqetësimi, qysh në gusht të vitit 1354, ambasadori venedikas në Kostandinopojë e njoftonte dogjin Andrea Donaldo se Bizantinët, të kërcënuar nga Osmanët dhe Gjenovezët ishin

---

<sup>541</sup> По аты, faqe 92.

<sup>542</sup>Shih: Theiner: *“Monumenta Hungariae I, 701 dhe Митрович: „Сукоб барског архиепископа и коротског епископа“*, стр. 300-302.



gati t'i nënshtroheshin cilësdo fuqi: Venedikut, sovranit të Rashës madje edhe mbretit të Hungarisë.<sup>543</sup>

Ishte kjo një gjendje dëshpëruese, që pasqyronte katandinë e Bizantit, por edhe pafuqinë e Perëndimit, që atë ta ndryshonte drejtpërdrejt.

Në pamundësi që në pjesën më të madhe të asaj që shfaqej si mbetje e Perandorisë të vihej ndonjë autoritet qendror, pra në rrethanat kur Osmanët ishin te dera dhe bëheshin gati për sulmet e tyre vendimtare, fillon shfaqja e “autoriteteve” vendore, në radhë të parë fisnikëve të fuqishëm dhe despotëve me principatat e tyre, fuqizimi i të cilave doemos kërkonte lidhjet e ndërsjella ose luftërat.

Përballë kësaj gjendje, pas vdekjes së Stefan Dushanit, u ndodhën edhe vendet e Arbrit në Ilirik, pushtimet e të cilit për rreth tri decenie kishin ndryshuar shumëçka, e mbi të gjitha kishin ndryshuar qasjen e fisnikëve, feudalëve dhe të zhupanëve, pra të atyre që kishin qenë pjesë e hierarkisë së pushtetit, ose që kishin drejtuar pronat e tyre, atë ta shfrytëzojnë në përputhje me interesat e veta kur tashmë ishte më se e qartë se ngrehina e Bizantit, tek e cila ishin mbështetur, ishte në grahmen e fundit, edhe pse kishte pretendentë për fronin e saj, që mund të stoliseshin me të, por assesi ta shpëtonin nga gllabërimet osmane. Kjo pra hapi garën, por edhe luftën e ndërsjellë nga të gjitha anët, ku kërkohet përvetësimi i pjesëve të shkëputura ose të pambikëqyrura të Perandorisë, që ishin kthyer në pre të përgjithshme, e jo të ndonjë zgjidhjeje më të qëndrueshme ku mund të mbrohej diçka.

Kjo prirje u bë edhe më e theksuar ngaqë zhupani i fundit rasian, Dushani, duke dëshiruar që të krijonte një hierarki sunduese nëpër pjesët e ndryshme të pushtuara që do të mbahej me anën e familjarëve të vetë (vëllezërve, të bijve, dhëndurëve), gjë që ishte në përputhje me logjikën bizantine të mbajtjes së pushtetit, me anën e kartave që të shumtën u ngjanin parasë pa mbulesë, kishte emëruar despotë dhe zhupanë të shumtë. Në rrethanat e reja ata vazhdonin të shfaqeshin gjithnjë me pretendimet krekosëse se ishin pjesë e një “kurore” perandorake e çmos, edhe pse realitetet flisnin për të kundërtën, pra për një gjendje pa pushtet, që shpejt mori kahun e shthurjes. Kështu, pas vdekjes së papritur të Dushanit, siç mund të pritej, kjo u kthye në një luftë të brendshme, në të cilën u përfshinë i biri i Stefanit, Uroshi dhe vëllai nga i ati i Stefanit, Simeoni për t'u bartur në të gjitha drejtimet. Grindjen për pushtetin që kishte mbetur vetëm në letë, nuk që në gjendje ta ndërpresë as e veja e Dushanit

---

<sup>543</sup> Contasmeno, G: “Byzantinische Geisterwelt”, Baden-Baden 1958; “Zeitgeschichte in der Rhetorik des sterbenden Byzanz”, 1969, faqe 152.

“perandoresha” Helena, e cila, e paaftë që të përballojë rrënimin e asaj që nga i shoq hiqej “perandor”, u tërhoq si murgeshë në një manastir ku mbeti përgjithmonë.

Megjithatë, gjithnjë sipas mënyrës bizantine, pasardhës i fronit, u shpall Uroshi, edhe pse ishte vetëm nëntëmbëdhjetëvjeçar. Atë e martuan me Anën (1360), vajzë e princit të Vllahisë, që kishte për motër bashkëshorten e pasardhësit të fronit bullgar, mbretit Strazimir, me çka bëhej e ditur se ai ishte këshilluar që t’u kthehej aleancave me Bullgarët në mënyrë që të kthehej në një faktor për të trashëguar Bizantin, pa marrë parasysh përmasat që do t’i kishte.<sup>544</sup>

Vëllai nga i ati i Stefanit, despoti Simeon, despot i vetëshpallur i Epirit, i këshilluar nga Bizanti, i cili edhe më tutje bënte hesape se mund të ringjallej me anën e një lidhjeje me Sllavët, Grekët dhe Arbrit, nxitoi që të shpallej “*Perandori i Grekëve, Rasianëve dhe krejt Arbërisë*” dhe, në përputhje me këtë pretendim, e quajti veten Simeon Urosh Paleologu, me çka formalisht shfaqej pretendent për fronin më të lartë, që duhej të mbështetej prej tre popujve kryesorë të Bizantit.<sup>545</sup>

Paraprakisht, ai u shfaq në Kostur me një ushtri prej pesë mijë ushtarësh, në mesin e të cilëve kishte edhe shumë Arbër, të cilët edhe më parë ishin përfshirë në ushtrinë e Dushanit, si mercenarë ose si pjesë që vinte nga detyrimi që kishin fisnikët dhe zhupanët, të cilët ia kishin falur besimin, duke përfituar prona dhe ofiqe. Por, pikërisht në këtë kohë, Simeon Urosh Paleologu, i cili ishte vetëshpallur “*perandori i krejt Arbërisë*” do ta hetojë kundërshtimin e Arbërve, të cilët do t’i shkaktojnë humbje ushtrisë së tij në Epir, pas së cilës u detyrua të largohet në Thesali, ndërkohë që zyrtarët tjerë bizantinë-rasianë, u detyruan të strehohen në Janinë.<sup>546</sup>

Duke dëshiruar të shfrytëzojë këtë gjendje, pra të largimit të forcave rasianë të mundura nga Arbrit, despoti Niqifor II Engjëlli, i cili kishte zbritur në Thesali dhe Epir me një anije lufte nga Enosi, bëri hesap që në këto pjesë ta zinte vendin e pushtuesve rasianë dhe të kthente disa nga fisnikët Grekë nga Morea. Ai, po ashtu, bënte hesap që me anën e një fushate luftarake të dëbonte popullatën arbëreshe nga këto anë. Madje, ai këtë kërkoi ta bënte edhe me Simeon Urosh Paleologun, i cili kishte pësuar një disfatë nga Arbrit. Por, Niqifori II Engjëlli, bashkë me stratotët e tij helenë dhe mercenarët turq në Ahelos (Astropotamo) pësoi një humbje të rëndë nga fisnikët arbërorë, ku edhe u vra (1358).<sup>547</sup>

---

<sup>544</sup> Jiriček, Konstantin: “*Historia e serbëve*”, Tiranë 2010, faqe 456.

<sup>545</sup> Shih: Rexha, Enver: “*Historiografia serbe për Kosovën XIII-XIX*”, Prishtinë 2009, faqe 92.

<sup>546</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, Tiranë 2002, faqe 281.

<sup>547</sup> Më gjerësisht shih: *Kantakuzenos IV*, kap 43 - Kronika e Janinës 31 gusht 1358.

Edhe pse thuhet se pas kësaj humbje të Niqiforit II Engjëllit, Simeonirestaurroi nga Kosturi edhe për disa kohë sundimin e Rashës në jug, në Epir ndikimi i tij mbeti i kufizuar nga fitimtarët mbi Niqiforin. Arbrit, të cilët ishin sundimtarë të vërtetë në Anhelos dhe në Artë, ishin në rrugë e sipër që kërkonin “partneritet” me faktorët tjerë në këto pjesë.<sup>548</sup>

Ngjashëm do të ndodhë edhe në Veri, kur në Diokle (Zetë), njëri prej ushtarakëve të Dushanit, Gjurash Iliq nuk do të shihej më, ndërkohë që qysh në vitin 1360 aty do të shfaqen vëllezërit Balsha: Strazimiri, Gjergji dhe Balsha, të cilët si princër, bashkë me të tjerët në Veri dhe në Jug, plotësojnë pjesët e mozaikut të formacioneve shtetërore të Arbërve në shekullin XIV dhe në fillim të shekullit XV, megjithëqë vazhduan të mbesin të shkëputura edhe atëherë kur shfaqeshin mundësi të mira për ndonjë bashkim politik midis tyre mbi bazat e ndonjë lidhjeje më të gjerë, gjë që kjo atyre ua ruajti namin e fuqisë pa politikë të përbashkët.

Lëvizja e shkëputjes nga pushtimi i përkohshëm rasian, me të shpejt u kthye në një veprim dinamik brenda kornizave të fenomenit të „separatizmit feudal”<sup>549</sup>, që në gjysmën e dytë të shekullit XIV karakterizoi në veçanti pjesën perëndimore të jug-lindjes europiane, si një zhvillim që i dha shtytje përparimit dhe ngritjes së idesë së “Arbërit” në një faktor të rëndësishëm shoqëror dhe politik, edhe pse nuk ia doli në tërësi të rrumbullakojë një kornizë shtetërore të përbashkët, ngaqë do të ndërpritet nga pushtimet osmane.<sup>550</sup>

Kështu, ndër këto familje, të cilat “paraqisnin një bërthamë të vërtetë shtetërore, ku kishin oborre, ku lëviznin fisnikët dhe bujarët dhe kishin edhe ministrat e financave (protovestiarët), zyrtarët (logofetët) dhe ”dhjakët” – administratën e drejtuar nga qefalitë dhe vojvodët”,<sup>551</sup> qenë Balshajt në Veri, Shpatajt dhe Zenebishët në jug, Thopiat në pjesët e mesme, Muzakajt në pjesën e Kosturit, familja Gropa në pjesën e Ohrit e deri në Dibër. Përfaqësues më të njohur familja Gropa kishte Adrea Gropën, me gjasë bir i Palit, të cilin Šufflay e quan “i fundmi sundues i krishterë i Ohrisë para pushtimit turk”, që do të përfundojë me Zaharia Gropën, i cili më vonë do të shfaqet në radhët e ushtrisë së Skënderbeut.<sup>552</sup>

<sup>548</sup> Jiriček, Konstantin: “*Historia e serbëve*”, Tiranë 2010, faqe 459.

<sup>549</sup> Shih: Šufflay, M: “*Povijest sjevernih Arbanasa*”, Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju II, Beograd 1924, faqe 14.

<sup>550</sup> Shih Plasari, Aurel: “*Skënderbeu*”, Tiranë 2010, faqe 165.

<sup>551</sup> Shih: Šufflay, M: “*Histori e Shqiptarëve të veriut*”, Prishtinë 2009, faqe 32-33.

<sup>552</sup> Shih: Šufflay, M: “*Die Kirchenzustände im vortürkischen Albanien*”, 238-239; “*Srbi i Arbanasi*”, f.125-126; Hopf: “*Chroniques, 532* (,XI Despotès et dynastes d’Epire et de Thessalie.8 Familille des Gropa d’ Ohrida”).

Krahas këtyre familjeve, në këtë kapërcyell kohe, qenë edhe disa familje të tjera (e Kastriotëve dhe e Dukagjinëve), që luajtën një rol të rëndësishëm në kuadër të spektrit shoqëror dhe politik të Arbrit në prag të pushtimeve osmane. Ato me të drejtë mund të vlerësohen si formacione shtetërore arbërore në shekullin XIV dhe XV, me çka edhe Arbrit, si edhe popujt e tjerë të Ilirikut (Tribalët rasiënë, Grekët, Bullgarët dhe Rumunët) me identitetin e tyre etnik, shoqëror dhe politik, bëhen pjesë e mozaikut të përbashkët me shumë copë, që ndonëse si i tillë do t'ua lehtësojë punën Osmanëve që t'i pushtojnë, megjithatë në këtë proces Arbrit hynë bashkë me bërthamat e tyre shtetërore si dhe me pamjen etnike e cila gjithnjë e më shumë po formësohej në përputhje me përmasat e saj të njëmendta, gjë që assesi nuk mund të thuhet se “pushtimi osman dhe islamizimi i shpëtoi nga sllavizmi, që po i kërcënonte me të madhe me anën e ortodoksisë”!

Përpyekjet që këto bërthama shtetërore të zgjeroheshin sa më shumë, edhe jashtë ndonjë lidhjeje të përbashkët, që karakterizonte “separatizmin feudal”, filloi jo rastësisht me rrënimin e despotatit të Dushanit, në përbërjen e tij thuajse ishin përfshirë edhe pjesa më e madhe e viseve arbërore, duke ruajtur autonominë feudale dhe princore. Me këtë rast u vunë në lëvizje thuajse të gjithë feudalët, bujarët dhe sevastët, por edhe pinjollët e fundit të Bizantit, të cilët gjendjen e re përpiqeshin ta shfrytëzonin sa më mirë dhe sa më shumë, paçka se kjo do të ndezë konfliktet midis familjeve të mëdha, të cilat deri më dje kishin raporte familjare dhe marrëdhënie të mira.

I tillë ishte edhe despot Niqifori II Engjëlli i Epirit, i cili, megjithatë, në rrugë e sipër për t'u forcuar pashmangshëm duhej të ndeshej me fisnikët arbërorë, të cilët tashmë shfaqeshin si faktor i pakapërcyeshëm të cilët përcaktonin fuqinë e përkrahësve ose të kundërshtarëve të Bizantit, të cilët pretendonin për fronin e tij (siç kishte qenë Dushani), ose për rrënimin e tij në dobi të Perëndimit. Në Akarmani, ushtria e tij e përforcuar me mercenarë osmanë, u thye keqas kurse despoti bizantin u vra. Pas kësaj beteje, krahinat jugore të Epirit, të Akarmanisë e të Etolisë u përfshinë në kuadër të dy despotateve të reja. I pari, me qendër në Artë, kishte në krye fisnikun Pjetër Losha, kurse i dyti, me qendër në Angjelokastër (Akamani), drejtohej nga despoti Gjini Bue (Shpata) Spata.<sup>553</sup>

Despotët e Arbrit edhe më tutje do të ndeshen me mbetjen e sundimit rasiën në Epir, Prelubeviqin, i cili kërkonte që këto pjesë t'i rikthente në pushtimin e vet, të cilin ai e drejtonte nga Janina. Gjini Bue Spata, pas martesës me motrën e

---

<sup>553</sup> Shih: “*Historia e Popullit Shqiptar*”, pjesa e parë, Tiranë 2002, faqe 281; Jacques, Edwin: “*Shqiptarët*”, Tiranë, faqe 189.

Prelubeviqit, lidhi njëfarë paqeje me despotin e Janinës, por asnjëherë nuk mbeti i qetë nga intrigat e tij. Ato u bënë edhe më të mëdha pas vdekjes së Spatës, kur vendin e tij e zuri i biri, Pal Spata, i cili nuk ishte në gjendje t’u bëjë ballë trysnive të ndryshme, të cilave do t’u shtohen edhe ato të Anzhuve dhe të Grekëve, kështu që lidhi paqe me Venedikun, nga e cila ruajti disa zotime, por humbi mbikëqyrjen ndaj pjesëve kryesore, siç ishte kështjella e Lepantos në bregdet dhe kryeqendra, Angjelokastra. Familja Spata sundonte në Arbërinë e Jugut ose në “Epirin e Veriut” në kapërcyell të shekujve XIV-XV, duke mbajtur si “despotate” Artën, Janinën dhe Gjirokastrën. Historia e kësaj familje shënohet nga lavdia, që ia solli Gjini, i cili ishte njëri ndër despotët më të fuqishëm, që mbante edhe çelësat e Korinthit, e deri te rënia në shërbim të Osmanëve, siç ishte rasti i nipit Jakub Spatës, i rritur dhe i edukuar midis Turqve, si dhe i muslimanizuar.<sup>554</sup>

Një familje tjetër fisnike nga Jugu ishte ajo e Zenebishëve, të cilët zotëronin tokat nga Gjirokastra, Delvina e këndeje në Vagenetis (Çameri). Zenebishët shënuan ngritje gjatë kohës kur kishin pranë Gjini Bua Shpatën e Artës, me të cilin kishin lidhje miqësore familjare, meqë Gjon Zenebishi ishte dhëndër i despotit të fuqishëm të Artës. Si edhe Shpatajt, Zenebishi do të ketë kundërshtar kryesor despotatin e Janinës, që drejtohej nga Italiani Ezau Buondelmonti Açajuoli (1386-1411), me të cilin do të ketë disa luftëra. Në njërin prej tyre, në Dhive (Mesopotami) italianin do të zihet rob prej Zenebishit, i cili do të lëshohet kundrejt një shpërblimi të majmë prej 10 mijë copë florinjsh.<sup>555</sup>

Meqë zotëronte pjesën bregdetare bashkë me Pargën, Zenebishi do të bjerë ndesh me Venedikun, i cili nuk do të resht së vepruari që ta largonte mbikëqyrjen prej atyre pjesëve, të cilat për republikën detare ishin me interes të madh për ta mbajtur të lirë lundrimin në këto pjesë prej nga mallrat e saj depërtonin në lindje dhe anasjelltas. Në vitin 1386, Venediku shtiu në dorë Korfuzin, ndërsa ia rrëmbeu edhe disa nga qendrat kryesore ushtarake ekonomike të bregdetit, Butrintin, Ksamilin dhe Sajadhën.<sup>556</sup>

Edhe pse kriporja e Sajadhës do të rikthehet, Zenebishi nuk qe në gjendje t’i mbrojë ato dhe pjesët tjera bregdetare. Venediku ishte shumë ngulmues, por do të jenë edhe rrethanat e tjera, siç ishin depërtimet osmane dhe intrigat e despotëve rasianë bashkë me ata Grekë në Epir, që e detyruan, në vitin 1414, të lidhte një aleancë me Venedikun, me të cilën, atij dhe familjes i garantohej strehim në Kor-

---

<sup>554</sup> Për familjen Spata shih Plasari, Aurel: “Skënderbeu”, Tiranë 2010, faqe 162.

<sup>555</sup> Po aty, faqe 285.

<sup>556</sup> Po aty, faqe 285.

fuz në rast të rrezikut osman, gjë që kështu edhe do të ndodhë, ku Gjoni do të kalojë ditët e fundit të jetës.

Krahasuar me Shpatajt dhe Zenebishët, që përfunduan duke kërkuar strehim nga Osmanët në gjirin e Venedikut, dy familje të mëdha arbërore, ajo e Thopiave dhe e Balshajve, ndonëse do të përfshihen në aleanca të ndryshme nga Lindja dhe nga Perëndimi, do të kthehen në protagonistë kryesorë të zhvillimeve që do t'u paraprijnë pushtimeve osmane.<sup>557</sup>

Këto dy familje të mëdha, luftën për t'u çliruar nga pushtimi i Dushanit, e kthyen në një luftë për shtrirje sa më të gjerë të zotimeve të tyre në të gjitha anët, që një ditë do të arrijë pikën kritik në një luftë të brendshme me njëra-tjetrën, ndër më të ashprat e botës së Arbrit asokohe, e cila do t'u kthehet në humbje të përbashkët. Lufta e Stavrës e vitit 1385, edhe pse epilogun, siç ishte humbja e Balshës dhe mbetja e tij në atë betejë, do ta marrë nga ndërhyrja e Osmanëve, të cilët për pak do të tërhiqen dhe “frytet” e asaj fitoreje do “t'i gëzojë” Thopia i cili do të kthehet në Durrës, kjo humbje ia hapte drejtpërdrejt perden pushtimit pesëshekullor osman në tokat e Arbrit.

Thopiat dolën në skenë diku në fillimet e shekullit XIII. Ishin ndër të parët që u shkëputen nga Bizanti për t'i bashkuar Azhuve të Napolit.<sup>558</sup> Si kundërshtim për njohje nga Papatia patën kushtin e kalimit nga riti ortodoks në atë latin. Kështu, dera e Thopiave, që drejtohej nga Tanushi, pasi që ndërroi ritin, qe ndër të parat që pranoi kurorën e Mbretërisë së Arbrit që e sollën Anzhotë. I biri i Tanushit, Andrea, edhe pse ishte i martuar me një vajzë të mbretit Robert, vritet nga njerëzit e tij, meqë nuk i shkoi përshtati.

Fuqinë më të madhe Thopiat e arriti gjatë kohës së Karlit, i cili erdhi në pushtet në vitin 1359, kur vendet e Arbrit kishin filluar ta hidhnin pushtimin e Dushanit. Edhe pse aleat i Napolit, Karli ia kishte vënë vetes qëllim rimarrjen e Durrësit, meqë me këtë qytet në zotim, ai rriste fuqinë e vet dhe kthehej në një faktor ndër më të rëndësishmit. Lufta për Durrësin, Thopinë nuk e ndeshte vetëm me Napolin, por edhe me Venedikun dhe Gjenovën, të cilat nuk mund të lejonin që ky qytet të mos ishte në duart e tyre. Që ta pengonte këtë, Venediku, madje,

---

<sup>557</sup> Më gjerësisht rreth familjeve Thopia dhe Balsha shih: “*Acta Albaniae*, (nga Šufflay, Jireček, Thalozcy) I, nr. 333 pass-817; II, nr 18; Hopf: Chrinique, 532 (“*XI. Despotēs et dynastes d’Epire et de Thessalie*”). 6. *Famille des Thopia, princes d’Albanie et seigneururs de Duras*) dhe Gelcich, Guiseppe: “*Zeta dhe dinastia e Balshajve*”, Tiranë 2009.

<sup>558</sup> Në historiografi emri Thopia (*Tobbia, Theopia*, etj.) shpesh gjendet i shkruar Topia, por bazuar në pjesën greqisht të mbishkrimit në manastirin e Shën Gjon (Jovan) Vladimirit (pranë Elbasanit), kuptohet që mbiemri i tyre ka qenë *Thopia* me *th* dhe me theksin në *i*. Trajta Thopia gjendet edhe në një dokument andegaven të vitit 1274: *Thopia miles*. (Shih: Plasari, Auresl: “*Skënderbeu*”, Tiranë 2010, faqe 156).

urdhëroi flotën e vet, të rrëronte flotën e Thopisë në det, para se ajo të forcohej sa duhej. Kur Thopia në vitin 1366 theu një sulm të fuqishëm të Gjergj Balshës drejt Durrësit, senati i Venedikut e shpalli atë qytetar nderi të Venedikut. Kjo nuk e ndali që ta marrë Durrësin, në të cilin ai hyri pas dy vjetësh. Thopiat do të shtrihen edhe në Jug, duke aneksuar zotimet e sebastokratit Vlash Matrënga, që shtrihej midis derdhjes së Shkumbinit dhe Semanit.

Ky zgjerim bëri që Muzakajt, të cilët shtriheshin nga Kosturi deri në Berat, të lidhnin një aleancë me Balshajt, me çka futeshin në një konflikt të drejtpërdrejt me Thopiat. Kështu, filloi edhe ajo që shfaqet si ngritje e brendshme e princërve të Arbrit në dëm të njëri-tjetrit dhe dobësim i tyre para të huajve, që për pasojë pati humbjen e përbashkët të tyre.<sup>559</sup>

Thopiat tash ishin të rrethuar nga kundërshtarë të jashtëm dhe të brendshëm. Anzhotë do t'ia dalin që për pak, në vitin 1372, pra njëqind vjet pasi që Karli I Anzhu të kishte shpallur "Mbretërinë e Arbrit" sërisht ta rikthejnë sovranitetin e Anzhuve në Durrës. Kjo nuk do të zgjasë shumë, meqë fushata e Gjergjit të Navarës, që pati bekimin e Papës Gregori XI, nuk ia doli të bënte tjetër pos t'ia lëshonte në duar Thopisë edhe fatin e Durrësit, të cilin ai e bleu nga Anzhotë pas dy vjetësh dhe kështu u bë njëri ndër faktorët më të fuqishëm arbëror.

Dominimi i Karl Thopisë nuk do të zgjasë shumë. Balshajt, armiqtë e tij të përbetuar, të cilët zotëronin Vlorën dhe ishin lidhur me Muzakajt në Jug, kërkonin me çdo kusht që të ishin të parët. Në vitin 1384, Balsha II, me një sulm befasues, e pushtoi Durrësin. Titullit të tij ia shtoi edhe atë "*Dukë i Durrësit*".<sup>560</sup>

Balshës kjo nuk do t'i shkojë gjatë. Meqë do të jenë Osmanët, të udhëhequr nga Hajredin Pasha, i cili tashmë ndodhej në More dhe u shfaq me ushtrinë e tij, kurse më 18 shtator 1385, në fushën e Savrës në Muzeqe, kryqëzoi armët me Balshën II dhe aleatët e tij, me ç'rast shënoi një fitore, ndërkohë që Balsha u vra në atë betejë. Durrësin ia lanë në dorë Thopisë, ndërsa Osmanët u tërhoqën. Sipas disa burimeve, Osmanët ishin të thirrur nga Thopiat, që t'i ndihmonin ta rikthente qendrën e vet, tek e cila i kishin sytë të drejtuar gjithë ata që kishin synime për të shtrirë fuqinë e tyre nga Perëndimi në Lindje.<sup>561</sup>

Kthimi në qendrën e tij kishte çmim të madh haraçi që Osmanët ia kishin vënë kontit të Durrësit, të cilin ai mendonte se do të mund ta anashkalonte po qe se lidh

---

<sup>559</sup> Shih: Edwin, Jacques: "*Shqiptarët*", Tiranë, faqe 190.

<sup>560</sup> Po aty, faqe 192.

<sup>561</sup> Gelcich, Guiseppa: "*Zeta dhe dinastia e Balshajve*", Tiranë 2009, faqe 147.

ndonjë aleancë me Venedikun, ose ndonjë fuqi tjetër perëndimore. Në këtë drejtim ai bëri disa përpjekje në Venedik, por mbeti jashtë loje, ngaqë venedikasit e dinin fort mirë se zotimet e Thopiave në Durrës dhe në përgjithësi në principatën e tij, ishin në shënjestër të Osmanëve, dhe se, çfarëdo hesapi me Thopiat prekte interesat osmane ndaj të cilave ata silleshin me kujdes. Pas vdekjes së Karlit, i biri, Gjergji, nuk ia doli të bëjë më tepër se një marrëveshje me Venedikun, që pas vdekjes së tij, i gjithë qyteti të kalonte nën sundimin e Venedikut, çështje kjo që do të mbetet pezull, pasi që në vitin 1415 Osmanët pushtuan kryeqendrën e vjetër të Arbrit dhe të Thopiave, Krujën. Ballaban Beu shfaqej si “*Subash i Krujës dhe i Arbrit*”.

Nëpër një ngritje të ngjashme do të kalojnë edhe familjet princore të Muzakajve dhe të Arianitëve. Muzakajt njihen si familje fisnike që nga koha e Komnenëve, kur Ana Komneni, përmend emrin e një fisniku nga familja Muzaka (*Misachi, Misachi, Musaičius etj.*) i cili rreth vitit 1090 ishte ndër komandantët e besuar të Perandorit Aleks I Komneni.<sup>562</sup>

Gjenealogjia e kësaj familje na është e njohur nga dokumenti “*Kujtesë e shkurtër e Don Giovani Muzakës despot i Epirit për bijtë e tij Don Theodor, Don Adrian dhe Don Kostandin, bijtë e tyre dhe mbasardhësive të tyre, nga ata pak që ai i mban mend më 1510*”.<sup>563</sup>

Prej 1280-1376, me disa ndërprerje të shkurta, një pjesë e mirë e Epirit të Ri, që quhej Myzeqe, ishte feud trashëgimtar i kësaj familjeje të përfshirë në konfliktet me dinastinë Anzhu, me Republikën e Venedikut dhe me despotët e Rashës. Zotërimi i tyre kishte qendrën në Berat dhe përfshinte viset mbi lumin e Vjosës, me shtrirje në Tumenisht, Selenicë-Tomorucë, si dhe një varg qytetesh të rëndësishme të zonës së Devollit, të Korçë e të Skraparit.<sup>564</sup>

Më 1315 Muzakët shfaqen “katolikë”, duke marrë pjesë në “kryqëzatën kundër skizmatikëve” të nxitur nga papati me ndihmën e mbretit të Hungarisë, të banit të Kroacisë (Mladenit II) dhe të zotëve arbër.<sup>565</sup>

Njëri ndër fisnikët e kësaj familje, Gjoni I Muzaka, shquhet në përkrahjen e “*Mbretërisë së Arbërisë*” së Anzhuve.<sup>566</sup>

---

<sup>562</sup> Shih: Anna Comnena: “*Alexios*”, bot. Schopen, vëll I, Bonn 1938, faqe 451,452.

<sup>563</sup> Më gjerësisht rreth gjenealogjisë së familjes Muzaka shih: Pëllumb Xhufi: “*Nga Paleologët te Muzakajt*”, Tiranë 2009, faqe 415-459.

<sup>564</sup> Shih: Plasari, Auerl: “*Skënderbeu*”, Tiranë, 2010, faqe 152.

<sup>565</sup> Po aty, faqe 152.

<sup>566</sup> Shih: Pëllumb Xhufi: “*Nga Paleologët te Muzakajt*”, Tiranë 2009, faqe 415-459. Burime të shumta bëjnë të ditur se Muzakajt paraqesin ekzemplar të tipik të familjes fisnike arbërore në mesjetën e mesme në rrethana kur kjo shtresë po kristalizonte vetëdijen e pavarësimin nëpërmes autonomisë ekonomike dhe politike në raport me faktorët e jashtëm dhe të brendshëm.



Andrea I Muzaka mbante titullin “*Mareshal i Arbërisë*”, dhënë nga Karli II Anzhu, por ai mbante edhe titullin bizantin *sevastokrator*. Ndërsa Andrea II Muzaka shihet në krye të një lëvizje antibizantine të viteve 1335-1341, me ç’rast në Durrës do të nënshkruajë një marrëveshje me Anzhutë e Napolit. Si vasal i mbretërve andegavenë të Napolit, ai mbante titullin “mareshal” dhe “*despot*” i Arbërisë.<sup>567</sup>

Pas thyerjes së lëvizjes antibizantine, shumë nga fisnikët e familjes Muzaka u shpronësuan dhe u detyruan të kërkojnë strehim në Greqi, në Peloponez. Gjatë kohës së pushtimeve të Dushanit, Muzakajt ishin frymëzues të qëndresës kundër tij dhe qeveritarit bizantin të zonës së Beratit dhe të Vlorës, despotit Ivan Komnen Asenit. Pas shpërbërjes së despotatit të Dushanit, Muzakajt zgjeruan kufijtë e pronave në drejtim të Korçës dhe të Devollit. Në këtë përballje ai pati punë edhe me sundimtarin Vukashin, atë kohë despot i Dardanisë dhe i gjithë Maqedonisë Perëndimore, kur në vitin 1370 theu ushtrinë e tij te Kosturi. Kjo bëri që Perandori i Bizantit, Johani V Paleologu, t’ia konfirmojë titullin e despotit. Një vit më vonë, Adrea II Muzaka, të birit të Vukashinit, Markut, ia mori Kosturin. Me pushtuesit sllavë do të ndeshen më vonë bijtë e tij: Gjoni, Teodori dhe Stoja. Por, në Luftën e njohur të Fushë-Dardanës të vitit 1389, Teodori, në krye të luftëtarëve arbër, vritet bashkë me ata, që i kishte pasur kundërshtarë të përhershëm.

Muzaka i fundit, Teodori III, më 1417 pranoi vasalitetin osman dhe mbajtën një pjesë të vogël të zotimeve të tyre të dikurshme deri në vitin 1478 kur Shkodra ra nën pushtimin osman. Me këtë rast, Gjon Muzaka, autor i njohur i gjenealogjisë së familjes Muzaka (1510), e la vendin dhe u vendos në Mbretërinë e Napolit. Si i shpronësuar, Gjoni në kishën madhore të Frankavilës në Otrant, la këtë epitaf domëthenës: “*Jezu i tërëfuqishëm, këtë arkë të shenjtë ta kushton Joan Muzaka bir i despotit Gjini, zot i viseve epirote të Myzeqesë, që ka për shënjesa fetare shqiptonjën bizantine me dy krerë të kurorëzuar, në vitin e Perëndisë 1510*”. Ishte shenjesa e Paleologëve të Bizantit, që Muzakët duket ta kishin marrë qysh kur Andrea II ishte bërë despot nën perandorin Andronik.<sup>568</sup>

Familja e Arianitëve (*Aranit, Arnit, Arnith etj.*) ka të ngjarë të lidhet me strategun e njohur të themës së Selanikut dhe pastaj të Shkupit, patricin David Arianitin nga viti 1001-1018, post që nga Perandori i Bizantit iu dha për meritat e tij ushtarake në luftë kundër Bullgarëve. Edhe i biri i tij, Konstantini, përmendet në

---

<sup>567</sup> Shih: Plasari, Auerel: “*Skënderbeu*”, Tiranë, faqe 152.

<sup>568</sup> Po aty, faqe 153.

vitet (1049-1050) si ushtarak i njohur në shërbim të Bizantit, i cili mori titullin “arhoni gjithë Perëndimit”.<sup>569</sup>

Ky titull i lartë si dhe disa tituj të tjerë perandorakë të kohës ka bërë që të veihen lidhje midis princërve të Arbrit dhe Arianitëve, prej nga rrjedh edhe vlerësimi se nga “shteti i Arbnit” mund të nxirret “Shteti i Arianitëve”.<sup>570</sup>

Në vitin 1274 përmendet edhe *Sebast* (*Sevast, Sevasto*) Aleks Arianiti.

Rëndësia e familjes Arianiti dhe fuqia e saj, shtohet edhe më pasi u lidh me familjen Kastrioti, kur vëllai i vogël i Gjergj Arianitit, Vladani, martohet me vajzën e Gjon Kastriotit, Angjelinën, pra motrën e Skënderbeut. Gjergji u martua me Marie Muzakën, me të cilën pati tetë vajza. Pas vdekjes së Marisë, Gjergji martohet me italianen Despina Frankon, vajzë e guvernatorit të qytetit Leçe të Mbretërisë së Napolit, gjë që të bijtë i lidhi me derën mbretërore napolitane, të cilën pinjollët e kësaj familje do ta përdorin në mënyra të ndryshme për ta ruajtur pushtetin.<sup>571</sup>

Familja e tij mbeti e lidhur me Kastriotët edhe gjatë kohës së Skënderbeut dhe vazhdoi të mbetet e fuqishme edhe gjatë kohës së Osmanëve, kur një nip i Gjergjit, sipas një dokumenti të fundit të shekullit XV, do të ushtrojë detyrën e një funksionari të lartë osman në rajonin e Vlorës, që do të shënohet si pjesë e “*Arbërisë së Arianitit*”, emërtim i përdorur krahas “*Arbërisë së Skënderbeut*”.<sup>572</sup>

Njëra ndër familjet më të fuqishme të Arbrit, që e shfrytëzoi vdekjen e Dushanit, për t’u ngritur me të shpejtë, duke u kthyer në një faktor të rëndësishëm, është ajo e Balshajve. Për Balshajt dihej se ishin një derë fisnike në Veri, që u shfaqën në vorbullën e ngjarjeve nga mesi i shekullit XIV për të mbetur në to si akterë të rëndësishëm për më shumë se një shekull. Sipas disa burimeve sundimi i Balshajve në Zetë (Diokle, Dukla) duhet të ketë nisur nga viti 1331 pasi që zhupani Dushan do të ketë shkuar në Rashë.<sup>573</sup> Kjo tregon se fuqizimi i kësaj familjeje duhet të ketë kaluar nëpër lidhjet familjare që kishte me despotin e Rashës, me despotin Vlq, lidh-

---

<sup>569</sup> Shih gjerësisht për Arianitët: Attaliatae: “*Historia*”, 34, 6-7; Babinger, Franz: “*Fundi i Arianitëve*”, Tiranë 2004; Shuflaj, M: “*Serbët dhe Shqiptarët*”, 2004, faqe 48-56; “*Historia e Popullit Shqiptar*”, I, Tiranë 2002, faqe 296-299; Shuteriqi, Dh: “*Mbi disa çështje t’Arbënit*”, 197-198

<sup>570</sup> Më gjerësisht rreth lidhjes midis “shtetit të Arbnit” dhe Arianitëve shih Dh. Shuteriqi: “*Mbi disa çështje t’Arbënit*”, 197-198; Hopf: “*Chroniques, 535 (XI. Despotēs et dynastes d’Epire et de Thessalie. 13. Famille des Arianiti-Comnenes)*”; “*Historia e Popullit Shqiptar*”, I, Tiranë 2002, faqe 296-298.

<sup>571</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, I, Tiranë 2002, faqe 298.

<sup>572</sup> Po aty, faqe 298.

<sup>573</sup> Shih: Gelcich, Giuseppe: “*Zeta dhe Dinastija e Balshajve*”, Tiranë 2009, faqe 31; Ljubić, K: “*Pregled Povjeti*”, Fiume 1864; Orbin „*Istoria del Regno degli Slavi*“, Pesaro 1601; „*Historia e Popullit Shqiptar*“, I, Tiranë 2002, faqe 301-305; Plasari, Aurel: „*Skënderbeu*“, Tiranë, faqe 147.

je kjo që pranohet edhe nga vetë Gjergj Balsha II, i cili në një dokument të tij të 27 janarit 1386 kujton paraardhësit e vet të nderuar Simeon Nemanjën dhe Savën.<sup>574</sup>

Për këto lidhje bën të ditur edhe Hopf kur Balshajt qysh më 1304 i sheh si manganë të oborrit të Nemanjajve, ndërsa një tjetër që pastaj sundoi Zetën, paskësh qenë gjeneral në ushtrinë e Stefan Uroshit, dhe, një i tretë paskësh qenë dërguar nga despoti Stefan Urosh për të qeverisur ishullin e Meldës në vitin 1357.<sup>575</sup>

Balshën e shohim sundimtar të Zetës në vitin 1360, i cili kishte vënë nën kontroll një territor më të gjerë që deri më atëherë e mbante Raguza, senati i së cilës ankohej për këto veprime.<sup>576</sup>

Pas vdekjes së Balshës, në vitin 1361, të bijtë, Strazimiri, Gjergji I dhe Balsha II ishin ndër të parët që përfituan nga gjendja e re, duke u drejtuar nga Dioklea (Genta ose Zenta) prej nga do të vazhdojnë drejt Jugut dhe Lindjes. Paraprakisht ata ia drejtuan senatit të Raguzës kërkesën për nënshtetësi raguziane dhe kërkesa u pranua nga senati i Raguzës, sepse te fuqia e Balshajve shihnin një mbrojtës të sigurt, siç e kishin pasur kohë më parë nga Nemanjasit, pushteti i të cilëve, pas vdekjes së Dushanit, kishte filluar të shthurej dhe nga kjo përfituan edhe Balshajt.<sup>577</sup>

Pak më vonë statusin e qytetarisë vëllezërve Balsha ua dha edhe Venediku, edhe pse ia kishin frikën zgjerimit të mëtejshëm të fuqisë që fitonin ata gjithnjë e më shumë në pjesët bregdetare, ku senjorisë mund t'i rrezikoheshin interesat. Kështu, ata u përpoqën që fuqizimin e Balshajve ta pengonin me anën e nxitjeve despotin Urosh të Rashës dhe Vojnovin të Sllavonisë.<sup>578</sup>

Në këtë rrugë ata nuk ishin në gjendje t'i ndalonte as Uroshi i Rashës, pushteti i të cilit po rrudhej nga princat arbër të liruar nga zgjedha nemanjase dhe as prapaskenat venedikase, që nuk munguan dhe si do të shihet, do të kenë një ndikim të madh në përvetësimin e një pjese të mirë të zotimeve të viseve arbërore qoftë edhe në aleanca me Osmanët dhe të tjerët që do të shfaqen pas pak. Kështu, ata morën Ulqinin, Tivarin, që pastaj t'i kthehen Shkodrës dhe skeles së Shirgjit. Në vitin 1367, morën Budvën me çka mbikëqyrnin lëvizjet tregtare nëpër Adriatik dhe me këtë shfaqeshin si njëri ndër faktorët më të rëndësishëm të kohës.<sup>579</sup>

---

<sup>574</sup> Shih: Mikloschić: "Monumenta Serbica", Wien 1858, faqe 203.

<sup>575</sup> Hopf: "Geschichte Griechenlands in Mittelalter", Berlin, 1912.

<sup>576</sup> Shih te Gelcich: "Monumenta Ragusina – Reformationes.III. Faqe 67

<sup>577</sup> Po aty, faqe 32.

<sup>578</sup> Shih: Gelcichm Guisepppe: Zeta dhe Dibastia e Balshajve", Tiranë 2009, faqe 41; "Historia e Popullit Shqiptar" I, Tiranë 2002, faqe 301.

<sup>579</sup> Gelcich, Giuseppe: "Zeta dhe Dinastia e Balshajve", Tiranë 2009, faqe 41.

Fuqinë e tyre si faktorë rajonalë, që nuk i mjaftonte vetëm deti, por edhe toka, veçmas ajo nëpër të cilën kalonin rrugët e vjetra perandorake “Via Egnatia” dhe të tjera që lidhnin bregdetin me Dardaninë dhe më këndeje me Lindjen, Balshajt e dëshmuar me depërtimet e tyre nëpër luginën e Drinit, prej nga iu drejtuan Dukagjinit për të arritur në Dardani (Prizren), që mbahej e pushtuar nga Uroshi, në mënyrë që të shkohej më tutje në lindje.

Shtirirja dhe depërtimet drejt Jugut, të cilat kryesisht duhej të shkonin nëpër zotërimet e Dukagjinëve, Zahariajve e Thopiave, e që principatës së tij ia jepnin përmasat e një shteti ndër më të fortit e kohës, si një faktor i ri midis Lindjes dhe Perëndimit, e ballafaquan Balshën me familjet kryesore fisnike arbërore, të cilat po ashtu bënë përpjekje t’i kthejnë zotërimet e tyre që ishin pushtuar nga Dushani ose Bizantinët në Epir dhe Thesali. Durrësi dhe Vlora, por edhe Berati, ishin disa pika që Balshajt do t’i shënjonë për t’i marrë medoemos, me aleanca - siç ndodhi me Muzakajt, ose me anë të luftërave - siç do t’i ndodhë me Thopiat e Durrësit.

Lufta për Durrësin me Thopiat do të jetë ndër më të rëndat për nga pasojat që do të përfytyrojnë vendet e Arbrit, meqë doli në pah se në ato rrethana tepër vendimtare, pretendimet dhe ambiciet princore kishin përparësi para konceptit për formimin e ndonjë lidhjeje të përbashkët të princave të Arbrit, që jo vetëm se mungonte, por nuk kishte gjasa as të shfaqej përballë rrethanave kur ata, secili në mënyrën e vet, luftonin për sa më shumë pushtet dhe hapësirë, që mund të arrihej vetëm në kurriz të njëri-tjetrit dhe asses ndryshe.

Përcaktimi i Balshës që edhe me anën e dorës së fortë të shtonte zotimet në të gjitha anët, zgjoi kureshtjen e fqinjëve, në radhë të parë të Venedikut. Skilja e Adriatikut, kishte interes për një fuqi që do ta lironte hapësirën në shturje e sipër të despotit të Dushanit nga një gjendje e turbullt me shumë zhupanë dhe princa të paparashikueshëm, por jo edhe për një princ tepër të fuqishëm, i cili do t’i diktonte kushte, siç do të ndodhë shpejt me Balshën, i cili pas pranimit të katolicizmit dhe lidhjes së drejtpërdrejtë me Vatikanin që iu akordua nga papa Urban V, kthehet në një faktor të rëndësishëm perëndimor përtej Adriatikut.

Nuk ishte vetëm fuqia ushtarake ajo që tashmë Balshën e bënte të fuqishëm në këto anë. Ishte edhe ajo kishtarë, në anën e Vatikanit, që atë e kthente në një konkurrues të dyfishtë: ndaj vendeve sllave dhe ndaj kishës ortodokse, paçka se kjo e bënte cak të Osmanëve, siç ndodhi në luftën e Stavrës të vitit 1385, të cilët pritim me vëmendje që në paralojën e përgatitjes së tyre për t’u futur në këto anë të gjithë të dobësoshin, por pa ndodhur që në atë luftë të brendshme me njëri-tjetrin të shfaqej ndonjëri që ngrihet shumë mbi të tjerët.

Në të vërtetë Beteja e Stavrës dhe fundi i saj tragjik për Balshën II, që u ndikua drejtpërdrejt nga pjesëmarrja e forcave osmane të drejtuara nga Hajredin Pasha, që u thirrën në ndihmë nga Thopia, dhanë paralajmërimin e tragjedisë së përgjithshme, që nuk do të vonojë, dhe do të vijë për të gjithë, katër vjet më vonë në Betejën e Fushës së Dardanës të qershorit të vitit 1389, në të cilën, krahas krerëve të tjerë arbërorë dhe ilirikas, mori pjesë edhe Gjergji II Balsha. Tri vjet më vonë, në një përndjekje me forcat osmane, Gjergji II Balsha shihet të ketë rënë rob i Osmanëve, që për t’u liruar ua lëshoi Shkodrën.<sup>580</sup>

Pas këtyre humbjeve Gjergji II Strazimiri (1385-1403), i ballafaquar me realitetet u përpoq të ruante sa më shumë që të ishte e mundur nga zotërimet e dikurshme, jo më me anën e luftës, por me anën e aleancave, në radhë të parë me Venedikasit, pa përjashtuar edhe përpjekjet që të lidhej edhe me Hungarezët, edhe pse ata ishin kundërshtarë të Venedikut. Lidhja me Venedikun Gjergjit II, pasi që ai do të heqë dorë nga shumë pjesë në dobi të Republikës së Adriatikut, i pranuar në gjirin e fisnikërisë veneciane dhe të Këshillit të Madh të Republikës, i siguroi një mbrojtje - veçmas pasi ia hoq qafesh rivalët nga dera e Cërnojeviqëve (njërin prej të cilëve Gjurashin në prill të vitit 1396, gjatë një fushate ndëshkuese, do ta vrasë) – por nuk ia ktheu mbrojtjen e përhershme. Sepse, kundërshtarët e tij të paepur, nga Dukagjinët, Jonimet e Zaharijajt si dhe princi Vuk Lazareviq, ishin kthyer në vasalë të sulltan Bajazitit I dhe e kërcënonin me të madhe nga të gjitha anët.<sup>581</sup>

Megjithatë, Gjergji II, i vetëdijshëm për rrethanat dhe realitetet, u përpoq që përkundër “mbrojtjes” nga Venediku, të ruante lidhjet edhe me Raguzën dhe Hungarinë, njëherësh kundërshtarë të Venedikut. Ndihma e tyre, ishte më shumë morale dhe, ndonëse vazhdonin ta quanin “*PrincepsAlbaniae*”, nuk i solli ndonjë dobi. Vdiq i vetmuar në vitin 1403 në qytetin e tij të Ulqinit.

Kundruall këtyre rrethanave, djali i Gjergjit II, Balsha III (1403-1424), pasi që i drejtoi sytë nga Hungaria, por njëherësh dha shenja edhe në drejtim të Osmanëve, se do të mund të ishte i dobishëm për ta, po qe se nuk do ta pengonin të rikthente Shkodrën dhe Drishtin nga Venediku, gjë që në vitin 1405 edhe ndodhi kështu. Ishte kjo një aventurë e rrezikshme, në të cilën u lëshua Balsha i ri (do të zgjasë mbi pesëmbëdhjetë vjet), në të cilën do të ketë sulme e kundërsulme të ndërsjella, disa marrëveshje paqësore, që nuk do të respektohen nga Venediku, në mënyrë që e gjitha të përfundojë me disfatën e pritur të Balshës III në prill të

<sup>580</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, I, Tiranë 2002, faqe 305.

<sup>581</sup> Gelcich, Giuseppe: “*Zeta dhe Dinastia e Balshajve*”, Tiranë 2009, faqe 76-79.

vitit 1421 gjatë një sulmi që ia bëri Kotorit kur Venedikasve u erdhën në ndihmë Osmanët me të cilët ata kishin lidhur marrëveshje, me çka njëherë e përgjithmonë kjo derë e fuqishme do të zbresë nga skena historike, jo si vasalë, siç do të ndodhë me shumicën e të tjerëve, por si humbës, që e kishte të parapërcaktuar nga një fuqi e cila ishte ndër më të rafinuarat që diplomacinë dhe dredhinë politike ta kthejë kurdoherë në favor. I dëshpëruar, disa muaj më vonë, pinjollit i fundit i Balshajve vdiq (më 26 prill 1421).<sup>582</sup>

Me këtë u mbyll kapitulli i njërit ndër despotatet më të rëndësishëm dhe më të fuqishëm të mozaikut shetjetformues arbëror në mesjetë, i cili vazhdoi me të tjerë, gjithnjë nëpërmes epiqendrave familjare, pra familjeve të mëdha, që në rastin shqiptar, si edhe të popujt e tjerë posaçërisht gjatë Mesjetës, etnisë së tyre i kanë dhënë ndjesi uniteti, me të cilën është siguruar vijimësi historike.<sup>583</sup>

Në këtë zhvillim historik të faktorizimit të pandalshëm të principatave të arbrit të dala nga epiqendrat familjare dhe vijimësia e tyre, qenë edhe dy familje arbërorësh: e Dukagjinëve dhe e Kastriotëve. Ato luajtën një rol të veçantë në zhvillimet që do t'u paraprijnë pushtimeve Osmane, meqë ato kthehen në bartës të asaj që shihet si pjesë e identitetit të caktuar shoqëror dhe shpirtëror arbëror, që buron nga një vetëdije historike, e cila lidhet me antikitetin mbi të cilin duhej mbështetur.

Kështu, Dukagjinët nxorën në pah vetëdijen për ligjin si pjesë e një rregulli të brendshëm shoqëror dhe institucional, që do të duhej të mbronte shoqërinë arbërore nga ligjet e jashtme, siç ishin ato osmane, që lidheshin me një qytetërim tjetër nga ai që kishin. Ndërsa Kastriotët, nxorën në pah institucionin e shtetit dhe sjelljen në përputhje me të, i cili ndonëse do të shfaqet në rrethanat e vasalitetit, megjithatë ishte i domosdoshëm që edhe Arbrit, si edhe të tjerët (Sllavët, Bullgarët, Grekët, Rumunët), që do t'i nënshtroheshin kësaj logjike në një kapërcyell kohor thujse njëshekullor, të deponojnë vetëdijen për shtetin, qoftë edhe si vasalë, pa marrë parasysh si dhe sa do të vlente në rrethanat e reja.

Në këtë mision historik, këto familje, të cilat, bashkë me të tjerat, do të përfshihen në zhvillimet e njohura, siç ishin ato që do të shfaqen nga koha e rënimit të despotatit pushtues të Dushanit e deri te ballafaqimi i drejtpërdrejtë me pushtuesit osmanë, kishin mundësinë që të silleshin në përputhje me këtë vetë-

---

<sup>582</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*” I, Tiranë 2002, faqe 306.

<sup>583</sup> Më gjerësisht rreth epiqendrave familjar dhe rolit të tyre për sigurimin e vijimësisë historike shih M. Šufflay: “*Histori e Shqiptarëve të Veriut*”, Prishtinë 2009, faqe 32-37; “*Povjest sjevernih Arbanasa*”, Arhiv za arbanasčku starinu, jezik i etimologiju, Beograd, 1924, f. 43-51; Plasati, Aurel: “*Skënderbeu*”, Tiranë 2010, f. 164-167.

dije, meqë gjeografikisht shfaqeshin në një nyjë lidhëse midis pjesës bregdetare dhe mesit me atë të Dardanisë dhe të Maqedonisë.

Meqë Dardania dhe Maqedonia, veçmas pjesa e Epirit, përherë kanë paraqitur një bërthamë të entitetit të përbashkët shoqëror dhe politik mbi të cilin për shekuj me radhë ishte mbështetur edhe Perandoria Bizantine, ishte e natyrshme që këto pjesë, të ktheheshin në shënjestër të përfituesve dhe rrënuesve kryesorë të Bizantit: Bullgarëve dhe Sllavëve nga shekulli X e këndej. Formacionet e tyre shoqërore dhe politike, fillimisht Mbretëria Bullgare e pastaj edhe zhupanët e Rashës, nga i pari Stefan Nemanja e deri te “megazhupani” Stefan Dushani, të cilët, pasi që, të ndihmuar nga Venediku e Vatikani, depërtuan nga pjesa perëndimore (Bosnja, dhe Zahlumia), ku e kishin bërthamën, të shumtën do të veprojnë në kurriz të Bizantit, në radhë të parë kundër vendeve të Arbërit.

Pushtimet bullgare dolën në pah qysh nga koha e Borisit nga gjysma e dytë e shekullit IX dhe më vonë e Simeonit kur ata pushtuan një pjesë të Dardanisë dhe të Ilirikut jugor. Ndërsa pushtimet e Rasianëve ndaj Arbërve u shfaqen me një ashpërsi të madhe pas Kryqëzatës së Katërt e këndej, bashkë me fushatat e perëndimorëve, që u kthyen kundër Bizantit. Andaj, ishte fare e natyrshme që hapësira arbërore, të sulmohen nga Veriu dhe Lindja si nga Bullgarët e më vonë edhe nga Rasianët, sepse nga aty mund të pushtoheshin ose të rrënoheshin themelet e Bizantit, të ngritura nga koha e perandorit Konstantinit të Madh dhe të Justinianin, paçka se aty si paganë, u sollën nga perandori Heraklit për ta mbrojtur atë.

Kjo sjellje, e filluar me pushtimet bullgare të shekujve IX-X dhe pjesërisht në atë XIII, dhe e vazhduar me Nemanjajt e Rashës, e toleruar nga Bizanti i greqizuar, te Bullgarët dhe Sllavët do të shohë armiqtë por edhe shpëtimtarët e mundshëm, do të dëmtojë rëndë strukturat shoqërore dhe shpirtërore të tyre, me të cilat, nga shekulli II e këndej, Iliro-Dardanët, me statusin e qytetarisë romake dhe pastaj asaj bizantine (*romaios*), ishin të përkushtuara ndaj Perandorisë dhe vlerave të saj me të cilat tashmë identifikoheshin. Madje, Bizanti, në përputhje me këtë hesap, që të shumtën do t’i kthehet në bumerang, lejoi që në këto pjesë të rrënohen edhe raportet tradicionale të *izopolitias*, model ky i partneritetit të qeverisjes autonome (*foedus*), i trashëguar nga koha romake. Andaj, nuk ishte e rastit pse Mbretëria Bullgare, në kohën e Simeonit barti qendrën e vet administrative dhe kishtare në pjesët e pushtuara të Dardanisë dhe të Maqedonisë (Ohër). Po ashtu, nuk ishte e rastit pse edhe Nemanjajt (nga Stefani, në vitin 1191, e deri

te i fundit Dushani në vitin 1335), herë pas herë, të bartin qendrën administrative dhe kishtarë në këto anë (Prizren e Scup).<sup>584</sup>

Meqë, zhupani i dikurshëm i Dushanit, Balsha ia doli që brenda një kohe të shkurtër dhe pa ndonjë mund të madh të heqë pushtimet e Dushanit (Ulqini, Tivari dhe Budva si dhe Shkodra) dhe prej andej ta zgjerojë principatën e veriut në drejtim të Durrësit e Vlorës në Jug dhe njëherësh luginës së Drinit të depërtojë deri në Prizren, depërtimet për në Dardani e çonin nëpër zotërime e familjes së Dukagjinëve. Bëhet e ditur se Dukagjinët lejuan kalimin e trupave të Balshës nëpër rrugën e vetme që çonte atje, por jashtë nënshtrimit.<sup>585</sup>

Megjithatë, pas rënies së Balshës në betejën e Stavrës, kur në të vërtetë filloi rrudhja e zotërimeve të tij, Dukagjinët dalin si pronarë të tokave nga Lezha duke mbajtur zotërimet në të dy anët e luginës së Drinit deri në Prizren. Po ashtu, Dukagjinët, kanë mbikëqyrur rrafshin e Dukagjinit nga Prizreni e deri në Pejë. Ata, me anën e dhëndrit të tyre Kojë Zaharisë, i cili kishte në mbikëqyrje pjesën e Dejës, lidheshin drejtpërdrejt me pjesën perëndimore të Dardanisë, e cila e lidhte atë me Shkodrën dhe Durrësin.<sup>586</sup>

Edhe pse pas vërshimeve të përkohshme të Osmanëve në pjesët veriore dhe të mesme, kur ata në vitin 1393 pushtuan për një kohë Krujën, Ulqinin, Shkodrën dhe Dejën, Dukagjinët ua dorëzuan Lezhën Venedikasve, dhe me këtë përkohësisht humbën mbikëqyrjen e rrugës Lezhë-Prizren, megjithatë Dukagjinët krahas ndërlihdjes së viseve të Arbrit (Prizrenit dhe Pejës), me ato veriore dhe bregdetin (Shkodrën dhe Lezhën), të cilat një kohë të gjatë i kishin mbajtur nën pushtim Rasha e Nemanjes dhe Dushani, duke u ngritur në nivelin e një principate kyçe, kishin lënë Kanunin, një akt legjislacioni që do të mbajë të bashkuar nga pikëpamja shpirtërore, shoqërore dhe politike, pjesën më të madhe të Arbrit. Kanuni i Lekë Dukagjinit, ose siç është quajtur edhe Kanuni i maleve, mbetet thujse i vetmi akt juridik që do të rregullojë jetën e brendshme të Arbërve në mënyrë autentike edhe në rrethanat e pushtimit osman.<sup>587</sup>

Kanuni i Lekë Dukagjinit, si institucion ligjor dhe moral, si një kushtetutë e brendshme që do të lidhë për vete pjesën më të madhe të Arbërve, atëherë e edhe më vonë, nuk ishte diçka e rastit, e aq më pak se mund të ketë pasur punë me “Zakonikun” e Dushanit, për të cilin shpeshherë është thënë se ishte pjellë e men-

<sup>584</sup> Shih: K. Jireček: „*Historia e Serbëve*”, pjesa e parë, Tiranë 2010, faqe 306-309.

<sup>585</sup> Shih: Frashëri, Kristo: “*Skënderbeu*”, Tiranë 2002, faqe 23-44.

<sup>586</sup> Jireček, Konstantin: “*Historia e Serbëve*”, pjesa e dytë, Tiranë, 2010, faqe 59.

<sup>587</sup> Më gjerësisht shih “*Kanuni i Lekë Dukagjinit*”, përdshirë në kuadër të kompletit “*Vepra*” 1, të Shtjefën Gjeçovit-Kryeziut, Prishtinë 1985.



dësisë së “megazhupanit” për ligjin dhe rregullin, që ua kishte lënë Arbërve dhe të ngjashme. Por fjala ishte për një vazhdimësi të Kodit të njohur të Justinianit, nga shekulli VI, kur ai do t’ia dalë që të kodifikojë ligjet dhe normat me të cilat ishte vetëqeverisur shoqëria ilire-dardane që nga antika e këndeje. Ky kod ka vazhduar të përdoret te Arbrit nga pushtimet e para bullgare e këndeje, pra kur do të bjerë sistemi ligjor perandorak i cili ishte pjellë e vetëdijes së tyre shoqërore për ligjin e kodifikuar nga Perandori i tyre, Justiniani I, për të vazhduar edhe gjatë pushtimeve sllave nga shekulli XIII e këndeje.<sup>588</sup>

Andaj, shikuar nga kjo pikëpamje, Dushani, si dhe Nemanjajt në përgjithësi, që nga shfaqja e tyre si pushtues në Dardani nga mesi i shekullit XIII e këndeje kur do të bien në kontakt me Arbrit, nuk kanë sjellë “rregulla e ligje” siç thuhet të shumtën, ngaqë ato nuk i kanë pasur asnjëherë, por i kanë marrë nga Arbrit, të cilët edhe më parë kishin Kanunin e tyre, që ua kishte rregulluar jetën e brendshme edhe para Justinianit, prej nga ai ishte fare e natyrshme që të mbështeste pastaj kodin e njohur perandorak. Madje edhe format e caktuara ligjore të “Zakonikut”, (çështja e pronës, e familjes, e hakmarrjes e të tjera), nëse shihen pak më shtruar, dalin të marra nga Kanuni i Arbërve, me çka del në pah e vërteta që një pjesë e historiografisë serbe e pranon se nuk ka pasë “Zakonik” të Dushanit, pos pjesëza që janë mbledhur (sajuar) në shekujt e mëvonshëm kur “shtetit mesjetar serb”, krahas konvertimit të Tribalëve në Serbë, është dashur t’i krijohej edhe “platforma ligjore”.<sup>589</sup> Këto forma ata do t’i përvetësojnë pak nga pak, ndërkohë që shpallja e tyre nga Dushani, nuk paraqet tjetër pos një përshtatje të disa neneve të Kanunit të Arbërve, të cilat pastaj do t’u shtohen disa të natyrës represive dhe diskriminuese ndaj të tjerëve (veçmas *Arbanashëve*, siç quhen ata, dhe vllahëve).

Tek e fundit, po qe se “Zakoniku” i Dushanit të ishte kod “origjinal” shoqëror dhe shpirtëror i Sllavëve i një niveli “perandorak”, siç pretendohet, ndërkohë Kanuni i Dukagjinëve imitim i tij, atëherë pse ai nuk do të mbetej në përdorim te Sllavët edhe gjatë pushtimeve osmane, siç do të ngjasë te Arbrit, kur ai me anën e

---

<sup>588</sup> Shih parathënien e Patër Gjergj Fishtës “*Kanunit të Lekë Dukagjinit*”, Tiranë, faqe XXVI-XXVII; Konitz, Faik: “*Ca kujtime mbi At Gjeçovin*”, te “*Kanuni i Lekë Dukagjinit*”, f.XXXIII.

<sup>589</sup> Rreth sajimit të “Zakonikut” të Dushanit në shekullin XIX, si dhe falsifikateve të shumta që atij t’i krijohet “platforma”, ndonëse pranohet se nuk ekziston origjinali, pos “pjesëzat e tij të shkëputura”, të cilat ia “rikonstruojnë tërësinë”, më gjerësisht shih Novaković, Stojan: “*Zakonik Stefana Dušana, cara srpskog 1349-1345*”, Beograd 1898, faqe LIX.

sistemit të *bylykbashit* do të pranohet edhe nga Osmanët si bazë që do të rregullojë vetëqeverisjen shekullore të mbi gjysmës së popullatës së saj?<sup>590</sup>

Kështu, mund të thuhet se Kanuni tek Arbrit, me variante: i Labërisë, i Skënderbeut, i Moresë, i Dukagjinëve, i Mirditës etj., edhe në formën si do ta ketë kodifikuar Jusitiani I në shekullin VI, ishte pjesë e një institucioni të brendshëm juridik të stërgjyshërve të tyre, Pellazgëve, format e të cilit, siç janë Këshilli i Pleqve, sjellja gjatë luftës, rregullimi i pronës e shumë e shumë çështje të tjera i gjejmë të përshkruara te “*Iliada*” e Homerit, të cilat von Hahn i ndërlidh me institucionin e ligjit ndër më të vjetrit e antikitetit. Studiuesi gjerman sjell shumë e shumë shembuj për përhapjen e shumë normave morale dhe juridike jo vetëm te pasardhësit e Pellazgëve, por edhe te popujt e tjerë: Gjermanët dhe Balto-Sllavët.<sup>591</sup>

Me këtë rast, thuhet se “*Këshilli i Pleqve*”, ashtu si ka vepruar në pjesën më të madhe të vendeve të Arbrit, kur ka marrë vendime siç janë ato që kanë të bëjnë me çështje penale, ato të pronës, ose edhe të familjes, pra mënyra e sanksionimit të këtyre çështjeve si dhe zbatimi i tyre ka shumë afri me atë të Romës së Vjetër, ku Senati propozon ligjet dhe i miraton ato nga përfaqësuesit, të cilët, në rastin konkret, vijnë nga fiset, si forma organizimi të njohura që nga antika.<sup>592</sup>

Nga kjo pikëpamje edhe familja tjetër princore, ajo e Kastriotëve, paraqet një referencë tepër të rëndësishme midis vetëdijes shoqërore të Arbërve për rregullimin e brendshëm me anën e institucionit ligjor, siç ishte Kanuni i Lekë Dukagjinit dhe vetëdijes për shtetin e përbashkët. Meqë koha e ngritjes së familjes së Kastriotëve (Gjonit) lidhet me dobësimin e dy familjeve të mëdha: Thopiave dhe Balshajve, pozicioni i saj shoqëror dhe politik kishte një rëndësi. Ajo ndërlidhte dy nga synimet kryesore të fisnikërisë arbërore në ato rrethana: në njërën anë lirin sa më të shpejtë nga ndikimi i Rashës, që edhe pas vdekjes së Dushanit, ishte në shpërbërje e sipër, trashëgimtarët e tij edhe më tej bënin përpjekje të mos lejonin lidhjen shoqërore dhe politike të principatave të Arbrit dhe, në tjetrën anë, krijimin e rrethanave për një afri me vendet perëndimore që t’u bëhet ballë pushtimeve osmane, të cilat tashmë kishin prekur vendet e Arbrit nga shumë drejtime.

Sa i përket çështjes së parë, pra të lirit nga Rasha tribale, edhe Kastriotët, vazhduan rrugën që kishte ndjekur Balsha dhe fisnikët e tjerë. Nga shumë burime

---

<sup>590</sup>Rreth vetëqeverisjes së shqiptarëve mbi bazat e Kanunit gjatë Perandorisë Osmane si dhe shtrirjes së gjerë nga veriu e deri në More si dhe strukturave vendore, shih: Novaković, Stojan: “*Tursko carstvo pred srpski ustanak 1780-1804*”, Beograd, 1906, faqe 162-188.

<sup>591</sup>Më gjerësisht shi: J. G von Hahn: “*Studimet shqiptare*”, Tiranë faqe 235-249.

<sup>592</sup>Po aty, 277.

mund të shihet se Kastriotët do të shtrihen edhe në drejtim të Dardanisë (deri në Prizren dhe Shkup), por nuk mund të thuhet me saktësi se të çfarë natyre ishin zotimet e tyre në këto pjesë, meqë Brankoviqët (në shumë dokumente mesjetare, si edhe Nemanjajt e Rashës, me origjinë tribalë),<sup>593</sup> që shfaqeshin si zotërues të një pjesë të kësaj treve (pjesët midis Prizrenit dhe Shkupit) kishin hyrë në raporte vasaliteti me Osmanët, ku ai nuk mund të prekte, pos që të ishte pronar i pjesëve të caktuara, që lejoheshin në kuadër të posedimeve të lira.<sup>594</sup>

Sidoqoftë, më shumë se për pushtet mbi ato pjesë, që megjithatë u mungojnë dëshmitë e qarta historike se ishin “pjesë të shtetit të Kastriotit” me ç’rast, madje atij i atribuohet edhe gjenealogjia familjare nga kjo pjesë (Hasi),<sup>595</sup> mund të flitet për prani ekonomike në këtë pjesë, me anën e tregtisë dhe veprimeve të tjera që kishte me disa tregtarë raguzianë dhe venedikas në këto anë.

Megjithatë, bie në sy se Gjon Kastrioti ia kishte dalë që të tejkalonte caqet e ngushta dhe të sillej në përputhje me dukjen e një fisniku të rëndësishëm, i cili bënte kujdes edhe për respektin ndaj kishave, me çka pasqyrohej edhe reputacioni shoqëror dhe politik madje, të domosdoshme për ta ushqyer dhe ruajtur identitetin e mirëfilltë të krishterë edhe atëherë kur, në rrethanat e pushtimeve, siç ishin ato që kërcënonin, mund të pushojnë së vepruari mekanizmat e tjerë. Kështu, ai krahas lidhjeve me Venedikun dhe kishën katolike, do të tregohet i vëmendshëm edhe ndaj kishës ortodokse së cilës i takonte si pjesa më e madhe feudaleve të asaj pjese, me ç’rast qendrës së saj në Hilandar në Malin e Shenjtë, në vitin 1426 i dhuroi dy katunde të veta nga pjesa e Gostivarit. Atje bleu edhe Pirgun e Shën Gjinit (i njohur edhe me emrin Pirgu Arbëresh - *arbanaški pirg*), ku qëndroi një nga djemtë e tij e Reposhi, i cili si murg e kaloi jetën deri sa vdiq më 25 korrik 1431.<sup>596</sup>

Bie në sy se zotërimet e Gjon Kastriotit u zgjeruan dukshëm pikërisht pasi e pranoi vasalitetin nga sulltani. Madje, edhe pasi që Kruaja ra në dorë të Osmanëve,

---

<sup>593</sup>Kronistëve bizantinë të shek. XIV: Halkonkondilit, Kristobulos, Dakos dhe të tjerëve, Nemanjajt i quajnë Tribalë si dhe popullatën që përfshinte despotatit të Rashës. Tribalë quhen edhe despotët Brankoviq dhe Lazareviq. Shih te Nikolić, Maja: “*The Byzantine Writers on Serbia 1402-1439*”, Beograd, 2010, f. 30,32,34 dhe 66. Nemanjajt e Rashës dhe në përgjithësi popullatën mesjetare të pjesës qendrore të Gashullit Ilirik, si Tribale e sheh edhe historiani Skendër Rizaj.

<sup>594</sup> Shih “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi parë, Tiranë 2002, faqe 316-318.

<sup>595</sup> Më gjerësisht rreth gjenealogjisë së Kastriotëve që lidhet me Hasin shih: Blanchus: “*Geirgios Castriotos*”, f. 70. Pikëpamjen e F. Bardhit (F.Blanchus) e ka parashtruar dhe mbështetur edhe Noli në studimin për Skënderbeun, pastaj Buda si dhe Biçoku (“*Nga ishin Kastriotët?*”), por ndaj saj kanë shprehur rezerva Frashëri, Kristo: “*Skënderbeu*”, Tiranë 2002; Plasari, Aurel: “*Skënderbeu – një histori politike*”, Tiranë 2010 dhe Schmitt, Oliver Jens: “*Skënderbeu*”, Tiranë.

<sup>596</sup> Rreth dhuratave të familjes Kastrioti Hilandarit shih: Barleti, Marin: “*Skënderbeu*”, Tiranë 1964; “*Historia e Popullit Shqiptar*” I, Tiranë 2002; Frashëri, Krishto: “*Skënderbeu*”, Tiranë 2002; Plasari, Aurel: “*Skënderbeu*”, Tiranë 2010.

Kastrioti tregohet i vëmendshëm që marrëdhëniet me Osmanët të mos shkaktojnë rënien e fuqisë së tij. Në këtë kohë ai lidhi disa marrëveshje me Venedikun dhe Raguzën, që të mbante të hapura lidhjet me këtë pjesë të botës, të cilat nëpërmes rrugëve të Veriut mundësonin qarkullimin e mallrave nga Shkodra në Prizren dhe Shkup. Këtë baraspeshë ai u mundua ta mbajë deri në fund, edhe pse ishte shumë e vështirë, veçmas kur nuk mund të vendoste më për fatin e aleancave me të mëdhenjtë (Osmanët dhe Venedikun), por që ata të kusuriteshin mes veti në kurriz të tij.<sup>597</sup>

Në këto rrethana, mund të thuhet se Gjon Kastrioti ia doli që ta krijojë një strukturë princore, që edhe si vasale e sulltanit, barazohej me ato të ngjashmet që kishin Sllavo-ortodoksët, Bullgarët, Grekët dhe të tjerët.<sup>598</sup>

---

<sup>597</sup> Frashëri, Kristo: *“Gjergj Kastrioti Skënderbeu”*, Tiranë 2002, faqe 5-20.

<sup>598</sup> Po aty.

PJESA E TRETË

PERANDORIA OSMANE



## KAPITULLI I PARË

### OSMANËTDHE BIZANTI

#### SHFAQJA E OSMANËVE NË ILIRIK

Tri data janë të rëndësishme për të shpjeguar ecurinë e pushtimeve osmane në pjesën europiane dhe kahun historik të tyre me ç’rasat krijohen disa nga parakushtet për t’u kuptuar një prej ngjarjeve më me peshë historike për Europën, por edhe për qytetërimin perëndimor në përgjithësi. Këto janë: viti 1354, viti 1371 dhe, viti 1389. Ndërsa, për Arbrit, krahas këtyre, edhe viti 1385, ka një domethënie të veçantë, meqë beteja e Savrës që lidhet me këtë datë, si dhe rrethanat në të cilat do të zhvillohet ajo (lufta e Osmanëve kundër Balshajve dhe disa feudalëve të tjerë arbër në afërsi të Durrësit si dhe “enigma” e ndodhjes së Thopijave në anën e Osmanëve), pasqyrojnë gjendjen e ndodhjes në fronte të ndryshme, që ishte përsëritur shpesh nga ndarja e kryqit e këndeje, së cilës i ishte paguar tagër i rëndë.

Viti 1354 paraqet kohën kur Osmanët, pas pushtimeve të Bursës në vitin 1326, duke kaluar Dardanelet hidhen në Gadishullin Ilirik, prej nga në vitin 1361 morën Adrianopojën, të cilën do ta quajnë Edrene dhe do ta shpallin kryeqytet të tyre. Për të arritur këtë Osmani I, ngarkoi të birin, Orhanin që Bizantit t’i hynte nga brenda. Kështu, Sulltan Orhani, pasi pushtoi Bursën e detyroi Perandorinë Bizantine të kthehej në aleate, me ç’rast Kontakuzeni duhej t’i jepte për grua të bijën, Theodorën Paleologinë-Kontakuzenë nga dera e Paleologëve, martesë kjo që sipas burimeve osmane u realizua më 1346.<sup>599</sup>

Se me këtë martesë edhe perandori bizantin kishte hesape me Osmanët, që do të vazhdojnë edhe me marrëveshje të tjera të ndërsjella, kjo ishte më se e qartë. Meqë me ndihmën e Orhanit, Katakuzeni kishte hyrë më 2 shkurt 1347 në Kostandinopojë dhe e kishte shpallur veten perandor, që si kundërshtpërbllim ndaj Orhanit atij do t’i jepej qyteti Çermenit (Çime) në Galipojë, ndërsa Orhani këtë

---

<sup>599</sup> Nga burimet osmane shih: “*Düstur-name-i Enveri*”, 67; “*Annali musulmani*”, X, anno 1348 dhe Plasari, Aurel: “*Skënderbeu*”, Tiranë 2010, faqe 185.

do t'ia kthejë me dërgimin e trupave turke në një fushatë të të birit Joanit V, Matheu Kontakuzenit në vitin 1357 kundër Bullgarëve. Pra, me këtë aleancë me Osmanët, e cila në njëfarë mënyre, Bizantin pak nga pakë do ta kthejë në vasal të Osmanëve, filloi edhe përdorimi i tyre për qërimin e hesapeve ndaj kundërshtarëve të brendshëm dhe të jashtëm (Perëndimit).<sup>600</sup>

Kjo “përvojë” do të përqafohet edhe nga të tjerët, veçmas Sllavët, Bullgarët, por edhe Arbrit, të cilët me Osmanët, do të lidhin marrëveshje dhe aleanca të herë pas herëshme për ta luftuar njëri-tjetrin, paçka se e gjitha atyre ua lehtësonte punën në rrugën për pushtime të reja në Europë.<sup>601</sup>

Hesapet e Bizantit me Osmanet vazhduan edhe pas vdekjes së Orhanit (1362) me të birin Muratin I. Ndonëse në fillim pati telashe me një kryengritje në Anadoll, vazhdoi depërtimin e kujdesshëm në juglindje të kontinentit evropian, këtë herë duke pushtuar pjesë të mira të Bullgarisë jugore dhe në Traki, të cilat do të kurorëzohen me pushtimin e Filipopolisit. Kjo nuk do ta mbrojë gjithaq Perandorin e pasigurt me pjesët e pakta që i kishin mbetur, që si u pa, do t'i detyrojë edhe kundërshtarët e tij që edhe ata t'i kthehen kartës osmane.

Por, ajo që ka rëndësi të theksohet me këtë rast ka të bëjë me atë se aleanca e parë bizantine-osmane por edhe marrëveshjet e deriatëherëshme me selgjuket në pjesët lindore, do të kthehet në pjesë të asaj “përvojë” që do të pranohet nga kisha lindore dhe popujt Sllavë rritit ortodoks, se në luftë kundër kishës perëndimore dhe Perëndimit në përgjithësi, duhej përdorur edhe ndihma e Osmanëve dhe e islamit madje. Do të jetë ky edhe një kapitull tjetër i përçarjeve të brendshme të të krishterëve me të cilin do t'u lehtësohet rruga pushtimeve osmane drejt kontinentit të vjetër një pjesë e të cilit do të bjerë nën sundimin e tyre shumëshekullor.

Viti 1371 paraqet, një etapë tjetër të rëndësishme për depërtimet osmane në Gadishullin Ilirik (të quajtur Gadishull Ballkanik në shekullin XIX) dhe për

---

<sup>600</sup> Edhe pse në Azinë e Vogël kishte kohë që Bizanti po humbte luftërat me formacionet e turqve selgjuke dhe ata sa po vinin dhe po i afroreshin edhe Bosforit prej nga do të hedhen edhe në pjesët jugore të kontinentit, vërehet se Selia e Shenjtë dhe vendet perëndimore edhe më tutje nuk kishin hequr dorë nga lufta kundër “herezive” brendapërbrenda krishterimit. Kjo më së miri kuptohet nga letra e Gjonit XXII (1316-1334), papa Bonifaci VIII (1295-1303) u kishte besuar françeskanëve inkuizicionin në Rashje, Dalmaci, Kroaci, Bosnje etj., duke shtuar edhe kryepeshkopatën e Durrësit. Sepse, në atë Kryepeshkopatë mbetej ende për t'u luftuar “herezia”. (Shih: Farlati: *Illyricum Sacrum*, IV, 58 (ASVAT); *Codex diplomaticus*, IX, 349; *Acta Bosnae*, 22 dhe *Acta Albaniae*, I, nr.724).

<sup>601</sup> Praktika e thirrjes në ndihmë të mercenarëve turq do të vazhdohet edhe nga Stefan Dushani në luftë kundër Perandorisë. Pastaj nga Bullgarët kundër Hungarezëve dhe Vllehve. Nga despoti i Epirit kundër Bizantinëve. Dhe kështu me radhë, zotë të tjerë të krishterë të rajonit, kërkonin “jashtë” ndihmën në sherret mes tyre, veprime këto që Jorga i ka quajtur “krime kundër besimit dhe racës”. (Shih te Plasari, Aurel: “*Skënderbeu*”, Tiranë 20120, faqe 185)



shtrirjen e mëtejshme të tyre në pjesën europiane, ngaqë, pas pushtimit të Adrianopojës, Osmanët pushtojnë edhe pjesë të tjera të Trakisë me çka despotët e shkapërderdhur të jugut europianë (Rasianë dhe Bullgarë, veçmas këta të parët që tashmë pretendonin edhe kurorën e Bizantit), për herë të parë ndjehen të rrezikuar seriozisht edhe nga dyshimi se Osmanët ishin aty në një rën anë ngaqë kjo mund të ishte pjesë e marrëveshjeve të perandorit Kontakuzen, tashmë në krushqi me sulltanin, që t'ia eliminonte kundërshtarët dhe, në tjetrën anë, ngaqë edhe vendet e krishtera europiane deri më atëherë kishin treguar më shumë vullnet dhe përkushtim që t'i përdornin ata si “digë” parandaluese kundër Osmanëve, se sa vetë të përfshiheshin në ndonjë aleancë të krishterë përmasasheuropiane që do t'u priste rrugën pushtimeve osmane.

Përkundrazi, bie në sy se në kohën kur disa nga feudalët dhe despotët e krishterë të Ilirikut Qendror po përpiqeshin të bënin ndonjë veprim kundër Osmanëve (ai në Maricë), kemi edhe marrëveshjet e para të perëndimorëve me Osmanët, me anën e të cilave, ata do të fitojnë kohë për pushtime të tjera dhe do t'i arrijnë edhe disa favore strategjike në raport me vetë Perëndimin, meqë marrëveshjet me ta nuk ishin tjetër pos veprime dinake kundër njëri-tjetrit qoftë edhe nën thirrjen e “unitetit kundër Osmanëve”. I tillë ishte “traktati tregtar” që lidhi Qyteti i Raguzës i vitit 1365 me Muratin I për mbrojtjen e tregtisë përkundrejt një haraçi prej 500 dukatesh, që Republika i ofronte vetë sulltanit, me çka mund të thuhet se Murati I ishte i pari i prijësve osmanë që hyri në lidhje me një shtet perëndimor europian.<sup>602</sup>

Përballë këtyre veprimeve dinake të perëndimorëve, Bizantinët kundërvepronin haptas me kartën osmane. Më 1362 perandori Joan V Paleologu (1354-1376), me Muratin I lidhi një traktat nëpërmjet të cilit njihte dhe konfirmonte pushtimet turke në kurriz të Perandorisë bizantine në jug-lindjen europiane, ku zotohej të mos lidhej me armiqtë e Osmanëve, t'i mbështeste këta me trupat e veta, madje duke vajtur edhe vetë në luftë për sulltanin, deri edhe duke i dhënë njërin prej të bijve si peng.<sup>603</sup>

Ky traktat vlerësohet si domethënës në histori jo vetëm për vënien e Perandorisë Bizantine në varësi të turqve, por edhe për njohjen e pranisë së tyre në kontinentin europian.<sup>604</sup>

---

<sup>602</sup> Shih Hammer, J von :”*Histoire de l’Empire Ottomane depuis son origine jusque’ a nos jours par J.de Hammer, vëll III-III* Paris /Londres/Sant-Petersbourg 1835-1836 , I 230-231; Miltitz: *Manuel des consuls*, II, 166. Ragusa do të përtërijë këtë traktat më 1408 me Sulejmanin dhe po ai traktat përtërihej edhe më 1414 me sulltan Mehmetin I. (Shih: Plasari, Aurel: “*Skënderbeu*”, Tiranë 2010 faqe 192).

<sup>603</sup> Shih Hammer, J von: “*Histoire*, I, 225 dhe 404 dhe *Annali musulmani*, X, anno 1346.

<sup>604</sup> Shih Plasari, Aurel: “*Skënderbeu*”, Tiranë 2010, faqe 192.

Edhe përkundër kësaj, megjithatë vërehen edhe përpjekjet e Bizantinëve, që në luftë të përfshiheshin edhe vendet katolike, të cilat edhe më tutje ishin të përqendruara që kjo barrë t'u mbetet ballkanasve, të cilët kush pse kishte pranuar vasalitetin, kush pse shikonte hesapet e veta, e kush pse i frikësohej fuqisë osmane, nuk tregonin gjithaq përkushtim për ndonjë luftë të drejtpërdrejtë me Osmanët. Se perandori bizantin synonte një luftë të hapur midis katolikëve dhe Osmanëve, kjo merret vesh nga disa veprime fshehurazi, siç ishte ai kur vetë Joani V shkoi në Hungari te mbreti Ludovik (Lajos) i Madh për t'i kërkuar luftë kundër turqve.<sup>605</sup>

Ka shumë gjasa që veprimet që do të ndërmerren nga mbreti Ludvik nëpërmes Amadeut VI të njohur si “konti i gjelbër” i Sevojës, me ç'rast Galipoja do t'u merret turqve dhe do t'u kthehet Bizantinëve (1366), ishin pjesë e taktikës së Joanit V, i cili thuhet se, që të bëjë për vete sa më shumë luftëtarë kundër Osmanëve, para papës Urban V mohoi “skizmën” dhe pranoi “besimin katolik”.

Kjo përkulje, si do të shihet, nuk do t'i sjell gjithaq dobi, ngaqë vendet perëndimore nuk i besonin më kurorës perandorake, se mund të bënte gjë, siç nuk ishin të gatshme që vetë të futeshin në luftë të drejtpërdrejtë me Osmanët.<sup>606</sup>

Mosbesimi i arsyeshëm i Perëndimit ndaj gatishmërisë së perandorit të Bizantit që të merrte përsipër luftën kundër Osmanëve, megjithatë i detyroi ata që nëse vetë nuk do të përfshiheshin në atë luftë, së paku të merrnin përsipër organizimin e ndonjë aleance, e cila do t'ua priste rrugën disi Osmanëve para se të bëhej vonë. Ishte Hungaria që u vu në kërkim të saj. Mbreti Ludovik ia doli që për atë luftë të përfshijë banin e Bosnjës, Uroshin e Rashës, Vojvodën e Vllahisë e ndonjë tjetër me të cilat Hungaria kishte pasur marrëdhënie të mira. Ftesë për të marrë pjesë në këtë aleancë, papa Urban V u kishte bërë edhe krahinave “të Tivarit, të Durrësit dhe të Patrës”.<sup>607</sup>

Bëhet e ditur se ushtria e të krishterëve, e komanduar nga mbreti Ludovik i Hungarisë kishte zbritur deri në Adrianopojën e pushtuar prej Osmanëve. Në këtë betejë, bejlerbeu i Rumelisë, Lalë Shahini, theu keqas të krishterët.<sup>608</sup>

---

<sup>605</sup> Po aty, faqe 193.

<sup>606</sup> Më gjerë rreth udhëtimit të Joanit V në perëndim shih: Norden “*Das Papstum und Byzanz. Die Trennung der beide Mächte und das Problem ihrer Wiedervereinigung bis zum Untergang des byzantinischen Reiches 1453*”, Berlin 1903. 708; Vasiliev: “*Il viaggio dell' Imperatore*”; *Anali musulmani*, X, anno 1369.

<sup>607</sup> Shih *Acta Albaniae*, II, nr.198

<sup>608</sup> Rreth kësaj betejë, sipas Plasari, Aurel “*Skëndebeu*”, Tiranë 2010, faqe 194 nga burimet osmane shih: Raiss Efendi: “*Annali degli osmanidi*”, 10, ndërsa nga burimet tjera shih Pray: “*Annales Rerum Hungariae*”, II, 126.

Pas kësaj humbje Osmanët shtuan veprimet e tyre luftarake thujse në të gjitha anët dhe pushtimet e tyre rrezikonin gjithnjë e më shumë pjesën qendrore të gadishullit. Përballë kësaj kemi edhe një aleancë tjetër të krishterë të rajonit mes mbretit Shishman të Bullgarisë, despotit Uglesha të Seresit, princit Vukashin të Rashës, knjazit Kostadin të Velbuzhit (Kostendil) dhe një kontingjenti të trupave bizantine. Ishte po ai Lalë Shahini që në Samokovo ua preu rrugën trupave të krishtera dhe i përçau, ndërkohë që knjazi Kostadin iu dorëzua Muratit.<sup>609</sup>

Përkundër përçarjes, më 26 shtator të atij viti (1371), u zhvillua beteja e dytë pranë lumit Marica, në Kermianon midis të krishterëve të Ilirikut, të cilëve u ishte bashkuar edhe Aleksandri i Vlorës, dhe Osmanëve të komanduar nga Lalë Shahini. Edhe në këtë betejë të krishterët e Ilirikut, kryesisht ortodoksë, pësuan humbje të rëndë. Në luftë ranë despoti Uglesha dhe princi Vukashin. Kjo pati për pasojë pushtimin e despotatit të Seresit dhe të Vllahisë si dhe pranimin e vasalitetit osman nga despotët rasianë, Bullgarë e të tjerë.<sup>610</sup>

Despoti hasian Lazar Grebljanoviq (bir i paligjshëm i Stefan Dushanit) pranoi vasalitetin me çmimin e një haraçi të dyfishtë ndaj Osmanëve dhe Bizantit.<sup>611</sup>

Haraçi “i dyfishtë”, paraqet një gjendje, që mund të kuptohet, vetëm po qe se kihet parasysh realiteti i Bizantit i krijuar pas vitit 1361 nga marrëveshjet midis Bizantit dhe sulltan Muratit I, sipas të cilave vartësit e Perandorisë (mendohet për despotët Ilirikas), pa marrë parasysh shkallën e autonomisë në raport me pushtetin qendror, në raportet e reja të vasalitetit me Osmanët, ishin të detyruar që një pjesë të haraçit t’ia paguanin edhe Bizantit.

Kjo praktikë vazhdoi deri në vitin 1453 kur ra Kostandinopoja në duar të Osmanëve dhe kishte për qëllim që sistemi i vartësisë (vasalitetit) të kalonte nëpërmes piramidës së ndërvartësisë që në ato rrethana u përshtatej Osmanëve si një mjet i përshtatshëm për të kaluar “natyrshëm” deri te akti final i pushtimit, që si do të shihet, megjithatë do t’i duhej edhe një betejë përfundimtare (e Fushë-Dardanës) disa vjet më vonë, e pashmangshme për vetë faktin se ajo përmbyllte një rënë fazë - atë të përfitimit të logut historik të përplasjes së krishterimit ndër shekuj (Selisë së Shenjtë dhe Kostandinopojës), me ç’rast i hapej rruga fazës

<sup>609</sup> Shih: Plasari, Aurel: “*Skënderbeu*”, Tiranë 2010, faqe 194.

<sup>610</sup> Më gjerësisht rreth Perandorisë Osmane, ngritjes së saj dhe pushtimeve të tyre në pjesën europiane dhe në juglindje të Europës, shih: Gibbons, H. A: “*The Foundations of the Ottoman Empire*”, Oxford, 1916; Hammer, P. Joseph von: “*Geschichte des Osmanischen Reiches*”, 1840; Jireček, K: “*Geschichte der Bulgaren*”, Sofje; Inalxhik, Halil: “*Perandoria osmane*”, Tiranë 2010; Imber, C: “*The Ottoman Empire 1300-1481*”, Istanbul 1990; Ostrogorski, Georg: “*Historia e Perandorisë Bizantine*”, Tiranë 2002; Frashëri, Kristo: “*Skënderbeu*”, Tiranë 2010; Plasari, Aurel: “*Skënderbeu*” 2013; Schmitt, Oliver Jens: “*Skënderbeu*”, Tiranë.

<sup>611</sup> Shih Hammer, Joseph von: “*Histoire*, I, 242 dhe 409.

tjetër, asaj të pushtimeve të tyre në qendër të Europës, të cilat ishin synim përfundimtar i Osmanëve.

## FILLIMET E SOVRANITETIT OSMAN NË ARBËRI

Para se të shkohet te viti 1389 dhe beteja e Fushës së Dardanisë, (e mitizuar në shekullin XIX dhe të shumtën e interpretuar në përputhje me falsifikimet e historiografisë serbomadhe), kur princat e bashkuar të Ilirikut (Arbër, Rasianë, Boshnjakë dhe Bullgarë të ndihmuar edhe nga vullnetarë Hungarezë, Polakë e të tjerë të krishterë), së bashku do ta humbin atë betejë vendimtare që do t'ia hapë rrugën pushtimit pesëshekullor osman, është viti 1385, i cili për Arbrit dhe Arbërinë, do të jetë i kobshëm. Në fushën e Savrës, në Myzeqe, ku do të shfaqet Timurtash Pasha dhe aty do t'ia marrë kokën Balshës, princat kryesorë të Arbrit (fjala është për Thopinë e Durrësit dhe Balshën), nuk ishin bashkë. Kishte kohë që ata luftonin kundër njëri-tjetrit dhe se kjo betejë duhej të përcaktonte “të parin” midis tyre.

Pavarësisht kësaj “ngatërrese” së cilës epilogun do t'ia japin Osmanët, është vlerësuar se ky kapitull hap fillimet e sovraniteti osman në Arbëri.<sup>612</sup>

Edhe pse kjo betejë diku shihet si pjesë paraprake e fushatës osmane në vendet e Arbrit,<sup>613</sup> e filluar me strategjinë e njohur të marrjes së saj me kujdes, ku feudalët arbërorë do të shfrytëzohen kundër-njëri tjetrit,<sup>614</sup> ndërsa diku tjetër shihet vetëm si një luftë e hapur midis dy princave arbër për mbizotërim të plotë, që kishte shpërthyer nga koha e vdekjes së Dushanit, kur nga të gjitha anët ishte ndezur lufta për rikthimin e tokave që ai kishte pushtuar dhe të tjerave në hapësirën bizantine pa zot, në të cilën Osmanët u “përfshinë përpak” pse u thirrën në ndihmë,<sup>615</sup> kjo lufte, megjithëqë pasqyron luftën e ashpër midis Balshës dhe Thopiave rreth “të pari” të Arbrit. Andaj ajo duhet parë edhe si strategji të Osmanëve,

---

<sup>612</sup> Më gjerësisht shih vlerësimin e Idrisi-i Bitelsi: *Hest Bihist*, 170 a-170 b - Nga *Lufta shqiptaro-turke*, 77-78, te Plasari, Aurel “*Skënderbeu*”, Tiranë 2010, faqe 211.

<sup>613</sup> Në historiografinë osmane (shih te Idrisi-i Bitlisi “*Hest Bihist*”, 170 a Nga *Lufta shqiptaro-turke*, 128) ruhet varianti sipas të cilit Karl Thopia tashmë ishte vasal i sulltanit nga koha e pushtimit të “vilajetit të Karli-ilisë” më 1382. Këtë mendim e përfaqëson edhe historiani i Balashëve Guiseppa Gelcich, për të cilin thotë se “Karl Thopia, i rënë nga fronti, u vendos në Krujë dhe aty i ujdisi mirë punët me turqit me shpresë se ata mund ta ndihmonin për ta marrë pushtetin”. (Shih “*Zeta dhe dinastia e Balshajve*”, Tiranë 2009, faqe 143). Interpretimi për “thirrjen” e turqve nga ana e Karl Thopisë gjendet edhe te Pulaha: “*Hyrje në Lufta shqiptaro-turke*”, 12 dhe 26.

<sup>614</sup> Më gjerësisht shih: “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i parë, Tiranë, 2002, faqe 287-292.

<sup>615</sup> Shih Chalcocondylae, Leonici: “*Historarum Demonstrationes*” I, Budapestini, 1922, faqe 45.

të shfrytëzohet rivaliteti midis feudalëve dhe princërve arbërorë, që prej andej nga ana e Adriatikut, jugut të Europës, t'i afroheshin sa më parë, pikërisht aty ku mund të mbrohej hinterlandi, siç ishte vepruar ngaherë dhe të përgatitej terreni për depërtime në thellësi të kontinentit.<sup>616</sup>

Pra, humbja e njërit (Balshës) dhe përfitimet e tjetrit (Thopisë), në të vërtetë tregonte për një gjendje të posaçme në të cilën ndodheshin Arbrit, të cilët, që nga shekulli XIII, (nga shfaqja e “*Perandorisë Latine të Kostandinopojës*” e këndeje), krahas trysnisë së pushtimeve të vazhdueshme që i vinin nga Rasha dhe atyre të më hershme bullgare nën sundimin e të cilëve do të përfshihen dy herë në një kohëzgjatje prej më shumë se një shekulli, tashmë ballafaqoheshin edhe me faktorin osman, pushtimet e të cilit, ndonëse rrezikonin të gjithë, shoqëroheshin edhe me veprime që dukeshin edhe të pakuptueshme njëherësh, siç ishin ato të krushqive të tyre me perandorin e Bizantit (Kontakuzenin IV) dhe aleancave me Osmanët kundër vendeve perëndimor, (e Paleologut kundër Gjenovës).

Ishte pra një gjendje e paparashikueshme kur lufta e pashmangshme e kryqit kundër gjysmëhënës osmane jo rrallë shmangej me një tjetër në të cilën kryqi luftonte kundër kryqit i ndihmuar nga gjysmëhëna osmane!

Kjo pra ishte korniza shoqërore dhe politike në të cilën u gjendën Arbrit dhe hapësira e tyre etnike kur Osmanët u shfaqen në viset e tyre.

Për t'u parë më së miri konteksti historik i atij zhvillimi, kur ata të shumtën do të shfaqen si vasalë të vasalëve e me këtë do të detyrohen që t'i përcjellin ngjarjet në përputhje me kahun që ua caktonin të tjerët, (të shumtën princat trialë të Rashës, që mbikëqyrnin një pjesë të mirë të vendeve të tyre), siç ishte Lufta e Maricës, ajo e zhvilluar në Beliqe të Bosnjës dhe e Fushë-Dardanisë, shumëçka e së cilës mbetet e paqartë, duhet rikthyer te paraqitja e faktorit osman në kufijtë lindorë të Perandorisë si dhe depërtimet kah pjesa perëndimore e Bizantit me çka, në masë të madhe, do të ndikohen që të gjitha zhvillimet shoqërore dhe politike të kohës brenda dhe jashtë përmasave perandorake.

Kështu, mund të thuhet se Osmanët ishin pasardhës të Turqve Oguzë. Këta filluan të depërtojnë në pjesët lindore të Perandorisë pasi që u shkëputen nga bërthama e tyre në Azinë Qendrore. Perandoria, fillimisht nuk do t'u kushtojë gjithë vëmendje depërtimeve të tyre, meqë kishte telashe me sjelljen e brendshme të Sllavëve dhe Bullgarëve, por edhe ato që i vinin nga Arabët, me të cilët do të ketë

---

<sup>616</sup> Jiriček, Konstantin: “*Historia e Serbëve*”, pjesa e dytë, Tiranë, 2010, faqe 137; Ostrogorski, Georg: “*Historia e Perandorisë Bizantine*”, Tiranë, 2002, faqe 382

ballafaqime të shpeshta dhe tepër sfiduese nga shekulli VII e këndeje. Ndeshja e parë e Bizantit me Selxhukët ndodhi në vitin 1071, kur ushtria perandorake pësoi humbje të thellë që për pasojë do të ketë humbjen e një pjesë të madhe të zotërimi-  
meve të tyre në Lindje.

Turqit Orguzë hynë në histori kur prijësi i tyre, Ertogrulli mori shpërblim prej sulltanit selxhuk një zotërim të vogël në brigjet e lumit Sangaria (Sakaria). Meqë shteti i Selxhukëve u shpërbë në shumë pjesë të vogla pas disfatës që i shkaktuan Mongolët në vitin 1243, ishte i biri i tij, Osmani I (1290 -1323), i cili zgjeroi zotërimin atëror dhe e ktheu në një shtet të pavarur me emrin Emirati Osman, që u bë bërthamë e Perandorisë Osmane. Me këtë rast Osmani I mori titullin e sulltanit dhe nënshtetasit e tij u quajtën Turq-Osmanlinj.<sup>617</sup>

Këtu, pra ndërlidhemi me vitin 1354, kur Osmanët kaluan në Ilirik, prej nga krijuan parakushtet për pushtime të mëtutjeshme, me të cilat pak më vonë do të prekin edhe vendet e Arbrit të shkapërderdhura në feude dhe despotate të shumta, të cilat pas vdekjes së despotit të Rashës Dushanit (një vit më vonë), ishin përfshirë në një zhvillim të rikthimit por edhe të zgjerimit të autonomisë së humbur gjatë pushtimeve rasiene. Kështu, familjet e njohura fisnike të Balshajve në veri, të Muzakajve, Thopiave dhe të tjerëve, filluan përpjekjet e tyre për zgjerimin dhe ngritjen e principatave të pavarura. Këtu dallohen Balshajt, të cilët pos zgjerimeve në veri, ia dolën që të marrin edhe Prizrenin dhe të vendosën në pjesën më të madhe të Dukagjinit.<sup>618</sup>

Në këtë zhvillim, që mund të quhet i brendshëm - meqë Arbrit silleshin në hapësirën e tyre dhe në përputhje me lojalitetin ndaj shtetit bizantin ku ai ishte i pashmangshëm, ose në marrëdhënie vasaliteti me perëndimorët, siç ishte Venediku, ku kjo ishte e pashmangshme - ata ndjenin për rrezikun osman, por pa ndonjë ballafaqim të drejtpërdrejtë me të. Madje, larg prej tij do të mbeten, edhe atëherë kur në vitin 1364, në Betejën e Adrianopojës, mundën ushtritë perandorake dhe atë e shpallën kryeqytet, me emrin Edrene.

Madje, në vorbullën e përpelitjeve për zgjerimin e principatave të tyre, qoftë edhe në dëm të njëra-tjetrës, siç ndodhte midis Blashajve dhe Thopiave, ata do të mbesin edhe gjatë ndeshjes së parë të një lidhjeje ushtarake të udhëhequr nga

---

<sup>617</sup> Inxhik, Halil: “Perandoria Osmane”, Tiranë 2010, faqe 381-382; “Historia e Popullit Shqiptar” I, Tiranë 2002, faqe 373.

<sup>618</sup> Rreth zgjerimit të Balshajve në Prizren dhe Dukagjin në vitin 1372 shih Jireček, Konstandin: “Historia e Serbëve”, I, Tiranë 2010, faqe 486; Gelcich, Giuseppe: “Zeta dhe dinastia e Bashajve”, Tiranë 2009, faqe 29-45; “Historia e Popullit Shqiptar” I, Tiranë 2002 faqe 304-307; Frashëri, Kristo: “Skënderbeu”, Tiranë 2009; Plasari, Aurel: “Skënderbeu”, Tiranë 2010.

zotët e Rashës vëllezërit Mërnajvçeviç (Vukashin dhe Uglesha) në luftën e Maricës të vitit 1371, kur forcat e tyre të ndihmuara nga ato Bullgare dhe Grekët pësojnë humbje të thellë, që për pasojë do të ketë pranimin e vasalitetit osman nga princat e Rashës si dhe ata të Epirit.<sup>619</sup>

Mospërfshirja e drejtpërdrejtë e Arbërve në orbitrin e veprimeve luftarake osmane nga koha e depërtimeve të tyre të drejtpërdrejta ushtarake në pjesën jug-lindore dhe vendosja në Bullgari e Thraki pasi që ta kenë pushtuar Andrianopolin (Edrenën) nga vitet 1345-1361, nuk do të thotë se ata kanë qenë “të kursyer” nga Osmanët nga koha e fërkimeve të para me Bizantinët (shekulli XI). Nga disa burime mësohet se “kontaktet” e para “te një natyre të veçantë luftarake” të Arbërve me Osmanët shënohen nga Perëndimi, me rastin e zbarkimit të Karlit Anzhu në Arbëri kur ai shpalli edhe “*Mbretërinë e Arbërisë*”.<sup>620</sup>

Në shënimet e venedikasit Sanudo thuhet, se Karli Anuzhu në Arbëri kishte edhe 200 shigjetarë saraqenë, të cilët, nën komandantin e tyre Musë, u përdorën në luftimet kundër trupave bizantine, por u përdorën edhe kundër “rebelëve arbër”.<sup>621</sup>

Pos në shërbim të Karlit Anzhu, mercenarët turq u panë të angazhuar edhe nga Perandori i Bizantit, Andronik II Paleologu, me rastin e shtrimit të despotatit të Epirit gjatë kohës së Niqiforit (12771-1269). Bëhet e ditur se një kontingjent i përzier Grekësh, Turqish dhe Kumanësh i vunë rrethimin Janinës më 1293.<sup>622</sup>

Burimet bizantine bëjnë të ditur se trupat osmane duhet t’i kenë njohur së pari viset e Arbërisë në vitin 6854 (1336/1337), kur Androniku III Paleologu, i thirrur nga despotina Ana Paleologinë-Engjëllinë, hyri në Arbëri dhe në Epir për të shtypur Arbrit e kryengritur në viset mes Valagrit, pranë Beratit dhe Kaninës. Perandori mori për këtë qëllim dy mijë turq mercenarë nga rrethi i Izmirit dhe Koinës dhe, me të ardhur pranvera, hyri me ta në “vendin e Ilirëve”.<sup>623</sup>

Por, gjendja nga “takimet” e tërthorta të mercenarëve osmanë në shërbim të perëndimorëve por edhe Bizantinëve për veprime të caktuara dhe të përkohshme në vendet e Arbnit, të cilat si do të shihen do të përdoren nga qarqe të larta

---

<sup>619</sup> Shih: Jirecek, C: “*Geschichte der Bulgaren*”, f.309; Nga i njëjti autor “*Historia e serbëve*” I, Tiranë 2010, faqe 480-485.

<sup>620</sup> Shih Plasari, Auerel: “*Skënderbeu*”, Tiranë 2010, faqe 203.

<sup>621</sup> Shih: Minieri-Riccio: “*Il regno di Carlo I*” XXII, 25 shën. 6; Hopf: “*Geschihte*,” I, 300 shën. 63 (ASN). *Acta Albaniae*, I, nr. 297, cit. Plasari, A: “*Skënderbeu*”, Tiranë 2010, faqe 203.

<sup>622</sup> Shih: “*Το Χρονικόν των Μορεωτών*”, II, 8792-9087. Edhe “*Chronique de Moree*”, 277-289.

<sup>623</sup> Shih: Gregorae: “*Historiae Byzantinae*”, I, 146, 544-545 dhe Joannes Cantacuzenus *ex Imperatoris Historiarum*, I, II, 495-501, cit. sipas Plasari, A: “*Skënderbeu*”, Tiranë 2010, faqe 204. Rreth veprimit të mercenarëve turq në Arbëri shih edhe “*Lufta shqiptaro-turke*”, 33 shën.6.

perandorake, do të ndryshojë sakaq, kur Osmanët, një vit më vonë, pasi që ta kenë marrë Plovdivin (kryeqytetin e Mbretërisë Bullgare) dhe Bullgarët të pranojnë vasalitetin osman, do të duken në Traki dhe Epir, siç ishin depërtimet e tyre në Shtip, Përlep dhe Manastir, Kostur dhe Ohër. Dhe, bashkë me Paleologun, gjendjen e vasalitetit do të detyrohen ta pranojnë edhe disa fisnikë dhe feudalë të Arbit, nga despotati i Epirit. Prej andej Osmanët do t'u afrohen edhe qyteteve bregdetare, ku e dinin se do të ndesheshin me Venedikun dhe perëndimorët, qëndrimi i të cilëve më së miri mund të testohej me pjesët që tashmë zotëronin princat e Arbit, qoftë edhe në gjendje armiqësie siç ishte ajo midis Balshajve dhe Thopiave.

Kështu, Savra ishte një sprovë shumë e mirë për Osmanët. Ata morën pjesë në atë betejë dhe përcaktuan fituesin madje, por njëherësh u larguan prej andej, në mënyrë që fitorja t'i "dhurohej" Thopisë si vasal, vasalitet ky që do ta pranojë edhe Muzaka dhe pjesa tjetër e feudalëve të Jugut, që nuk ishte tjetër pos një paralajmërim se ajo që kishte filluar nuk kishte të ndalur.<sup>624</sup>

Në të vërtetë, "tërheqja" e përkohshme e forcave osmane nga Savra (për rreth dy vjet), ishte një matje që Osmanët ua bënë venedikasve si dhe faktorëve të tjerë perëndimorë si do të silleshin pas hapave të tyre të mëtejshëm, që nuk mund të ishin ndryshe pos në përputhje me taktikën e pranimit të vasalitetit, që u krijonte favore të mëdha, qoftë pse përfitonin nga haraçi që ua caktonin vartësve të tyre, të cilët ashtu dhe në atë mënyrë "akomodoheshin" në rrethanat e reja të një perandorie dhe të një qytetërimi tjetër, i cili në rrethanat e kaosit që mbretëronte dhe pasigurisë së përgjithshme sillte pak siguri, qoftë pse ashtu përgatiteshin për depërtime të mëtejshme kah Perëndimi, të cilat paraprakisht kërkonin "paqësimin" e pjesëve që lidhnin Lindjen me Perëndimin, por që ky "paqësim" të dukej si pasqyrim i një realiteti që mund të ishte i dobishëm edhe për ta, veçmas nëse ai krijonte përshtypjen e një zhvillimi ekonomik me të cilin lidheshin edhe interesat e feudalëve vendorë.

Me siguri se "paqja" midis vasalëve të krishterë, ku tashmë me dëshirë dhe pa dëshirë ishin të përfshirë edhe shumica e Arbërve me zotërimet dhe titujt e tyre, që nuk thoshin shumë, do të mund të vazhdonte edhe për një kohë të mirë, ose edhe më gjatë, po mos të ishin perëndimorët, të cilët, meqë e dinin se gjendja e tillë "akomoduese" jashtë ngulfatjeve dhe anarkisë së shekullit të fundit në të cilën ishte përfshirë Perandoria jo edhe pa "meritat" e shumta të tyre që lidheshin me dobësimin apo rrënimin e saj nëpërmes forcimit të despotëve Sllavë dhe

---

<sup>624</sup> Rreth thirrjes që ua drejtoi Thopia turqve për t'i ndihmuar në luftë kundër Balshës II si dhe vasalitetit shih gjerësisht Gegaj, At Athanas: "Arbëria dhe Gjergj Kastrioti Skënderbe 1405-1468", Tiranë 1995, faqe 33.



Grekë, do t'u shkonte për shtati Osmanëve, që të përgatiten sa më mirë për pushtime të reja drejt qendrës europiane, do të fillojnë t'i nxisin ata që të luftojnë kundër Osmanëve, edhe pse e dinin se e gjitha do të përfundonte me disfatë. E rëndësishme ishte që të fitohej në kohë, pa marrë parasysh çmimin që do t'i paguhej nga Ilirikasit.

Natyrisht, se përballë kësaj gjendjeje me shumë paqartësi dhe druajtje, por edhe shpresa se mund të mbrohej diçka, fitohej përshtypja se despotët dhe princat e kurorës së shprishur të Bizantit nga pjesa e Ilirikut dhe Dardanisë ishin të detyruar për t'iu dhënë një veprimi të përbashkët, sado që shpejt do të shihet se edhe aty kishte hesape të caktuara dhe hile të ndryshme. Të përkrahur dhe të këshilluar nga misionarët e shumtë nga vendet katolike, në vitin 1387, filloi nisma për krijimin e një koalicion të gjerë të Ilirikut. Edhe pse e gjitha do t'i përshkruhet knjazit tribal të Rashës Llazar Hreblanoviçit, prej nga vinë ftesat për veprim të përbashkët, megjithatë prapa saj gjenden Selia e Shenjtë, Venediku, e mbi të gjitha Hungaria. Kjo e fundit, madje, kishte shumë arsye të ishte e nxehur, pasi që ishte në shënjestër të fushatës së ardhshme osmane kundër Europës, e cila duhej të kalonte pashmangshëm nëpër tokat e saj.

Lëvizjet e të krishterëve të pjesës perëndimore të Bizantit, të nxitura drejt-përdrejt nga perëndimorët dhe nën flamurin e krishterë, që mund të përdorej si emblemë e vetme “bashkuese” në ato rrethana edhe pse në emër të tij të krishterët kishin zhvilluar shumë e shumë lufta mes veti, vunë në veprim edhe Osmanët, të cilët për ta siguruar shpinën dhe për të nxjerrë nga loja çfarëdo veprimi të Bullgarëve hapësira e të cilëve tashmë paraqiste një faktor të rëndësishëm strategjik drejt qendrës europiane, gjatë vitit 1388, përqendruan forcat e veta në Plovdiv në vijën drejt Nishit, qytet ky të cilin e kishin pushtuar para dy vitesh, ndërkohë që jashtë mbikëqyrjes osmane kishte mbetur pjesa nga Rasha deri në Prishtinë dhe Shkup, pra qendra e Dardanisë, pjesët e së cilës pjesërisht shfaqeshin si zotërime të princit të krishterë, Vuk Brankoviç, me prejardhje tribale (nga familja e të cilit kishte prejardhjen edhe bashkëshortja e Gjon Kastriotit Vojsava),<sup>625</sup> e pjesërisht gjendeshin nën zotërimin e Balshës, ndërsa rruga Lezhë-Prizren gjendej nën mbikëqyrjen e Dhimitër Jonimës.

---

<sup>625</sup> Më gjerësisht shih: Petrovski, Boban: “*Vojsava Tribalda*”, në simposiumin “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, Shkup, 2006, faqe 67-77. Se Brankoviçët ishin Tribalë, pra mbetje e një fisi antik të afërt me Dardanët, por sipas kronistit bizantin Halkokondilit “*Tribalët ishin degë ilire*” (shih: “*Historiarum Demonstrationes*” I, Budapesti, 1922, faqe 24-25). Këtë e thonë edhe Barleti dhe Gjon Muzaka, të cilët kur bëjnë të ditur për bashkëshorten e Gjon Kastriotit, Vojsavën, tregojnë se baba i saj ka qenë Tribal.

## LUFTA E DARDANISË E VITIT 1389 – MIDIS REALITETIT DHE MITIT

Në fillim të qershorit trupat osmane, pasi që kaluan Nishin, iu drejtuan Fushës së Dardanisë, ku tashmë, krahas ushtrive të disa sundimtarëve të Arbrit (Gjergjit II Balshës - bir i Strazimit nga Shkodra, që ishte dhëndër i Lazarit (kish-te marrë për grua të bijën Jelenën), pastaj Teodor Muzakës nga Myzeqeja, Dhimitër Jonimës, zot i trevave përgjatë rrugës Lezhë-Prizren dhe të Andrea Gropës nga Ohri),<sup>626</sup> po i prisnin ato të Princit tribal të Rashës Llazarit me ato vendore (dardane) të dhëndrit të tij, Vuk Brankoviçit. Atyre u ishin bashkuar edhe forca rumune të drejtuara nga Vojvoda Mirçea, trupat kroate nën drejtimin e banit kroat, Ivan Horvat, dhe të Bosnjës në krye me mbretin Tvrtko.<sup>627</sup>

Sipas disa burimeve historike, Beteja e Fushë-Dardanisë filloi më 15 qershor të vitit 1389 dhe përfundoi po atë ditë, diku në orët e mbrëmjes me humbjen e forcave të lidhjes së krishterë ilirike.<sup>628</sup>

Në betejë gjetën vdekjen Sulltan Murati I, që thuhet se u vra nga Milesh Kopili, një fisnik vendor nga radhët e Arbërve<sup>629</sup>, nga Sllavët i quajtur *Milloš*, fillimisht *Kobilić*, ndërsa më vonë *Obilić*. Mileshi ishte dhëndër i princit Llazar, dukuri kjo e njohur e martesave në rrethanat mesjetare. Vdekjen e gjeti edhe Llazari, pasi që ishte zënë rob lufte. I njëjti fat e gjet edhe Milesh Kopilin, i

---

<sup>626</sup> Rreth pjesëmarrjes së Arbërve në luftën e Fushës së Dardanisë, shih: Pulaha, S: “Lufta shqiptaro-turke në shek. XV – burime osmane”, Tiranë 1968 faqe 297; Sathas, C: “Bibliotheca Graeca Medii Aevi” vol, I, 1872, f.247-248; “Kronika e Gjon Muzakës”, faqe 301-365 te Xhufi, Pëllumb: “Nga Paleologët te Muzakajt”, Tiranë 2009; “Historia e Popullit Shqiptar”, I, Tiranë 2002, faqe 366-367; Frashëri, Krishto: “Skënderbeu”, Tiranë; Frashëri, Kristo: “Shqiptarët dhe beteja e Kosovës”, në “Rilindja javore” 9-15 korrik 1995; Gegaj Athanas: “Skënderbeu”, Tiranë 1995; Mallezu, L: “Shqiptarët në betejën e Kosovës”, Tiranë 1998; Plasari, Aurel: “Skënderbeu”, Tiranë 2010, faqe 194,195. Ndërsa te autorët osmanë: Soklakszade: “Tarihi,” 43; Nesri: “Kirâb-i Cihân-nüma”, 70-72,80; Idris-i Bitlisi: “Hest Bihist”, 182; Sa’deddin: “Tâcü tevarih”, 120, Uzunçarşılı: „Osmanli Tarihi”, I, 200, 249; Oruç Ben Adil; “Tevarih-i al-i osman”; Inalxhik, Halil: “Perandoria osmane”, Shkup 2010, etj.

<sup>627</sup> Më gjerësisht shih: Hammer, Joseph von: “Geschichte des Osmanischen Reiches” vol. I Pest, C. H. Hartleben 1840; Jireček, K: “Historia e Serbëve” I, Tiranë 2010, “Geschichte der Bulgaren”, Prague 1876; Gelcich, G: “Zeta dhe dinastia e Balshajve”, Tiranë 2009, faqe 169-171; Jorga, N: “Geschichte des osmanischen Reiches nach Quellen dargestellt”, vëll, I-II, Gotha 1908-1909; Fine, J. V. A: “The Early Medieval Balkans”, Michigan 1983; Mallcom, Noel: “Kosova një histori e shkurtër”, Prishtinë 2001, faqe 59-67; “Historia e Popullit Shqiptar”, I, Tiranë 2002, faqe 336.

<sup>628</sup> Mospërputhja në datë ka të bëjë me pranimin nga ana e Serbëve të Kalendarit gregorian më vonë se Europa; për Osmanët data është 19 Jumada II 791, pra 15 qershor 1389. Edhe përkundër kësaj dallimet vazhdojnë. Kështu, K. Frashëri përmend datën 27 qershor (shih: Skënderbeu, Tiranë, faqe 42), ndërkohë që edhe një pjesë e mirë e historiografisë serbe përmend datën 27 dhe 28 qershor.

<sup>629</sup> Rreth përkatësisë arbërore të feudalit Milesh Kopili shih: Maltezi, L: “Beteja e Fushës së Kosovës (1389) dhe kontributi i Shqiptarëve”, Studime historike, Tiranë 1989 dhe “Mbi pjesëmarrjen e Shqiptarëve në Betejën e vitit 1389 dhe përkatësinë etnike të Millosh Kopiliqit”, Tiranë 2005; Historia e Popullit Shqiptar, I, Tiranë 2002, faqe 376; Rizaj, Skënder: “Shqiptarët dhe serbët në Kosovë”, Prishtinë 1991 dhe “Kosova dhe shqiptarët dje, sot dhe nesër”, Prishtinë, 1992; Malcolm, Noel: “Kosova një histori e shkurtër”, Prishtinë 2001, faqe 69-83.

cilidiku në shekullin XIX, kur do të ndërtohet miti i Kosovës për qëllime hegje-moniste serbe, do të kremtohet “hero nacional serb”. Ndërkohë që shqiptarët, duke u mbështetur mbi vazhdimësinë historike të etnisë së tyre në këto pjesë nga antikiteti e këndej, do ta trajtojnë “të tyre”.

Nga prijësit arbërorë në betejë mbeti edhe Muzaka. Po atë ditë, sulltanin e vrarë, e zëvendësoi i biri, Bajaziti I, i njohur me nofkën “*Jëll-dërëm*” (Rrufeja).<sup>630</sup>

Edhe pse nga këndvështrimi i fakteve historike kjo luftë mbetet me shumë të panjohura, veçmas pënga përmasat e njëmendta (shumë e shumë më të ngushta nga ato të përshkrimeve të shfaqura në shekullin XIX), dhe rolit të faktorëve vendor në të (jashtë ndonjë aleance të gjërë ushtarake, të shumtën me njësi vullnetarësh), megjithatë disa të dhëna për ato që solli kjo luftë, tregojnë se Osmanët kaluan në një fazë të re të konsolidimit të pushtimeve në Ilirik, duke krijuar para-kushte për pushtimet e mëtuqjeshme në drejtim të qendrës së Europës. Kështu, nga këto burime bëhet e ditur se Bajaziti, pasi që i theu forcat e lidhjes së krishterë, nuk u tregua ndëshkues ndaj humbësve, siç pritej. Përkundrazi, bëri vasalë Vuk Brankoviçin, për të cilin disa burime thonë se i iku betejës, pse gjoja kishte disa mospajtime me vjehrrin e të ngjashme të krijuara nga në shekullin XIX nga historiografia serbe për qëllime hegje-moniste me të cilat bëhet përpjekje të vazhdueshme që tribalët dhe arbërit e përkatësisë ortodokse t’i konvertojnë në serbë, me çka gjoja “tradhtia e dhëndrit” bëhet shkas i humbjes deri te kremtimi në vasal “të armikut”, gjë që kjo për një serb “të njëmendët” nuk mund të thuhet.<sup>631</sup>

Duke u thirrur në burime nga fusha e folklorit dhe pa argumente të mjaftueshme historike, të cilat mund të gjenden pikërisht te çmitizimi i kësaj lufte me anën e trajtimit shkencor të faktorëve të gjithëmbarsëm etnik dhe shoqëror e politik të kohës në përputhje me rrethanat që sollën te agonia e Bizantit dhe fuqizimi i osmanëve e të tjera të kësaj natyre, edhe disa studiues shqiptarë, duke u mbështetur mbi faktorin e etnosit autokton me vazhdimësi dardane, mbrojnë qëndrimin për përkatësinë arbërore të Milesh Kopilit dhe të tjerëve si një vetëdije

---

<sup>630</sup> Më gjerësisht shih te Uzunçarsili: “*Osmanli Tahiri*”, I, f. 200, 249-250; Hammer, Joseph von: “*Geshichte des Osmanischen Reiches*”; I, Pest, C. H. Hartleben 1840; Gelcich, Giuseppe: “*Zeta dhe dinastia e Balshajve*”, Tiranë, 2009, faqe 169-171; Ćorović, V.: “*O Kosovskom boju 1389*”, në “*Zadužbina Kosova*”, Prizren-Beograd 1987; Ćorović, V.: “*Istorija srba*”, Beograd 1989; “*Istorija srpskog naroda*”, Beograd 1994; Jovanović, K.D.: “*O Arbanasimia*”, istorijska studija, Beograd 1880; “*Kosovska bitka i posledice*”, grup autorësh, Beograd 1991; Kovačević, L.: “*Istorija Srpskog Naroda*” I,II., Beograd.

<sup>631</sup> Më gjerësisht rreth kësaj shih: Debeljković, Dena: “*O Kosovskom Boju*”, në “*Antologija Srpske Narodne Epike Kosova i Metohije*”, 1964; Kostić, Dragutin: “*Miloš Kopilić-Kobilić-Obilić*”, *Revue Internationale des Etudes Balcaniques*, I, 1934; Subotić, Dragutin: “*Yugoslav Popular Ballads*”, Cambridge University Press, 1932; Djordjević, Tihomir: “*Boj na Kosovu*”, Beograd, 1934.

autoktone të krishterë të përbashkët, qoftë ortodokse ose katolike dhe assesi asaj kombëtare, e cila shfaqet në shekullin XIX.<sup>632</sup>

Pavarësisht kundrimeve të ndryshme, rreth përkatësisë së atyre që epika historike e njërës apo tjetrit popull do t'i shfrytëzojë si mite në shërbim të kujtesës historike dhe kthimit të saj në një frymëzues të vetëdijes nacionale, siç ishte ajo e shekullit XIX e këndej, megjithatë, mund të thuhet se ndeshja kyçe historike midis të krishterëve të Ilirikut dhe Osmanëve, gjatë qershorit të vitit 1389 apo aty diku afër, gjithsesi se duhej të ndodhte në Dardani, ngaqë ajo ishte përcaktuese për ecurinë e mëtutjeshme të pushtimeve osmane në Europë, në një hapësirë gjeografike, e cila, nga antikiteti shfaqej si nyje prej nga mbikëqyrej hapësira euro-aziatike. Ndaj, një perandori, që pretendonte të arrinte përmasat botërore, siç ishte asokohe ajo osmane, duhej të vendosej aty, siç kishte ndodhur edhe me fatin e perandorive paraprake dhe të ndarjes së krishterimit madje.<sup>633</sup>

Andaj, ngritje e Osmanëve drejt Perëndimit, ishte e natyrshme të fillonte në kurriz të të krishterëve të Ilirikut, por njëherësh edhe me ndihmën e tyre, që ndonëse qenë të parët që do t'i kundërvihen (në luftën e Maricës e pastaj në Fushë-Dardani), pas humbjes në këtë të fundit, do të kthehen në vasalë të osmanëve, gjendje kjo që do t'i ndihmojë forcimit dhe shtrirjes së pushtimeve të tyre drejt botës perëndimore.<sup>634</sup>

---

<sup>632</sup> Më gjerësisht shih: Arapi, Fatos: “*Këngë të moçme shqiptare*”, Tiranë, 1986; Drançolli, Jahja: “*Në kërkim të origjinës së Millosh Kopiliqit*”, Prishtinë, 2006; Pirraku, Muhamet: “*Pjesëmarrja e Shqiptarëve në betejën e Kosovës 1389*”, Gjurmime Albanologjike, seria e shkencave historike, Prishtinë, 1990; Pulaha, Selami: “*On the Presenc of Albanians in Kosova during the 14th-17th Centuries*”, Tiranë, 1993; Rizaj, Skënder: “*Falsifikimet e Historiografisë Serbe/The Falsifications of Serbian Historiography*”, Prishtinë, 2006; Murzaku, Thoma: “*Lufta e banorëve të tokave lindore*”, Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 1969; Drançolli, J: “*Njof-time burimore rreth origjinës së Molosh Kopiliqit*” “*Illyria*” nr. 441, 1995

<sup>633</sup> Rreth Betejës së Fushë-Dardanës dhe rëndësisë së saj ka vlerësime të ndryshme shpesh kundërtëne: nga ato që e zmadhojnë (“*Kjo fitore e stabilizoi fuqishëm sundimin e turqve në Ilirik*” - Inalxhik, H: “*Perandoria Osmane*”, Shkup 2010; ose: “*Beteja që do të vendosë për pesë shekuj fatin e Gadishullit Ilirikut*” – Miller, William; “*The Balkans*”) e deri te ato që e zvogëlojnë fare, siç janë vlerësimet e historianit rumun Jorga kur thotë se “1389-a nuk pati qenë veçse një incident i stërmadhuar prej legjendës”). Zmadhimin të namit të kësaj beteje jashtë çdo mase gjithsesi se i kanë ndimuar disa nga kronikanët osmanë, duke filluar nga bejtet e e Ahmedit të shekullit XV “*Kuajt çapiteshin mbi kufomat që ishin kat-e-kat mbi njëri tjetrin*” (shih te Ahmedi: “*Dastan ve Tevarih*”, 50) si dhe kronikat e Shukurullahut, për të cilat Pulaha thotë se “Shukurullahu dhe të gjithë kronikët osmanë past tij, me qëllim që të rrisin sa më shumë fitoren e turqve osmanlinj në Kosovë më 1389, thonë se koalicionin e feudalëve Ilirikas morën pjesë edhe vellehët, çekët, hungarezët, Bullgarët e venedikasit. Në të vërtetë ky pohim është i gabuar, sepse në këtë koalicion morën pjesë vetëm sllavët, boshnjakët dhe Shqiptarët”. Për Pulahën të ekzagjeruara janë gjithashtu edhe shifrat që japin këta për ushtrinë e koalicionit. (Shih “*Lufta shqiptaro-turke*”, 31 shën.10)

<sup>634</sup> Shih Fine: “*Late Medieval Balkans*”, Michigan f.293-309; Oikomondies, N: “*The Turks in Europe*”, faqe 159-62.

Ndër këta ndihmës, të parët dhe më të dobishmit për sulltanët ishin pikërisht Rasianët, të cilët fazën e fundit të dobësimit dhe të shthurjes së Bizantit e shfrytëzuan për t'u forcuar në kurriz të tij. Me ta do të lidhen aleancat më të qëndrueshme, të cilat nga koha e Bajazitit I e këndeje, të shumtën, do të shkojnë në dëm të të krishterëve të Ilirikut, por edhe të krishterimit perëndimor në përgjithësi.

Ç'është e vërteta, lidhjet e Rasianëve me Osmanët kishin filluar më herët. Kjo tumir vlerësimin se historia e ekspansionit osman në Ilirik ishte një histori e bashkëpunimit të tyre me të krishterët e ritit ortodoks, që mbështetej mbi shembëllesën e perandorëve bizantinë (Kantakuzeninit) si dhe përvojën e tyre me Osmanët në pjesët lindore të Perandorisë nga fillimet e shekullit XIII e këndeje, që ua hapën rrugën pushtimeve të tyre të mëtejshme që u dinamizuan nga fillimet e shekullit XIV e deri në atë XV. Kështu, njësitë turke të mercenarëve në këto pjesë shfrytëzohen nga despoti rasian Millutin, duke i përdorur kundër ushtrisë bizantine. Disa burime flasin për rreth njëmijë e pesëqind ushtarë turq të fisit kuman që u vendosën në Rashë.<sup>635</sup>

Përvojën e përdorimit të mercenarëve turq do ta shfrytëzojë edhe Stefan Dushani. Bëhet e ditur se Dushani kishte disa njësi kumanësh në ushtrinë e tij, me anën e të cilave bënte hesapë ta fitonte "kuroren" e Bizantit. Kjo nuk do të ishte jashtë një hesapi me Osmanët, të cilët mund të kishin interesa që në planet e tyre për të depërtuar këndeje drejt zemër së Europës të fusnin në lojë lojtarë të përdorshëm, siç ishin Rasianët, të njohur për veprime të tilla.<sup>636</sup>

Madje, disa burime të vonshme flasin për paralojën e atij hesapi, me të cilin duhej të ndikohej edhe në epilogun e Betejës së Dardanisë, ose një të ngjashme që do të kishte ndodhur para ose pas, në dobi të Osmanëve, që pastaj të përfitohet prej saj me lidhjen e një marrëveshjeje paqësore me Osmanët, me ç'rast, gjithnjë nën ombrellën Rasiene me të cilën do të zëvendësohet ajo e Bizantit, princat ortodoksë të Ilirikut, në përbërje të Perandorisë Osmane, do të mund t'i ruanin disa nga privilegjet e tyre, pa çarë kokën se çfarë do të bëhej me vendet katolike.<sup>637</sup>

---

<sup>635</sup> Më gjerësisht rreth mercenarëve osmanë në shërbim të despotit Millutin shih: Oikonomides, N: "The Turks in Europe 1300-1315 and the Serbs in Asia Minor 1313", faqe 159-62 në E. Zachariadou, bot, "The Ottoman Emirate 1300-1389", 1993; Jireček, C: "Staat und Gesellschaft in mittelalterlichen Serbien" II, faqe 58.

<sup>636</sup> Shih: Malcolm, Noel: "Kosova një histori e shkurtër", Prishtinë 2001, faqe 61; Mavramitis, L: "La Fondation de l'empire serbe: le kralj Milutin", Salonica 1978; faqe 72, Jireček, C: "Staat und Gesellschaft in mittelalterlichen Serbien", I, faqe 78.

<sup>637</sup> Rreth lidhjeve të Rasianëve me Osmanët para se të kenë filluar konfrontimet ushtarake me ta, por që do të vazhdojnë edhe pas betejës së Fushës së Dardanës, shih autorët e shumtë, ndër të cilët Jozef von Hamer: "Geschichte des Osmanischen Reiches", 1827; Zinkesen J. W: "Geschichte des osmanischen Reiches in Europa", Hamburg-Gota 1840-1863; Jorga, N: "Geschichte des osmanischen Reiches", Gotha 1908-13; Dölger F: "Re-

Para historisë nuk mund të fshihet as fakti se po në Luftën e Fushës së Dardanisë, forcat e një bujari rasiën, të quajtur Dejanoviq, luftuan në anën e Osmanëve, siç pati edhe shumë vllahë nga principata e tij në anën e Osmanëve, praninë e të cilëve e vërtetojnë edhe burimet osmane.<sup>638</sup>

Nga kjo sjellje mund të nxirret përfundimi se te Osmanët, Sllavët ortodoksë dhe të tjerët që i takonin kësaj vetëdije, veçmas rasiënët tribalë, jo rastësisht, shihnin “shpëtimtarin” e vetëm që mund t’i mbronte “nga rreziku katolik”, i cili nuk reshte së vepruari kundër tyre.<sup>639</sup>

Pa marrë parasysh ato që do ta përcjellin disfatën e të krishterëve të Ilirikut në Dardani, gjatë asaj beteje të stërmadhuar në shekullin XIX, ose ndonjë tjetre, që gjithsesi ka ndodhë, sjellja e Bajazitit ndaj të krishterëve të Ilirikut (rasianëve tribalë, Bullgarëve, Rumunëve, Arbërve, Sllavëve, Grekëve dhe të tjerëve), tregon fare qartë se ai ishte i përqendruar te ata që ta shfrytëzonte forcën e tyre për vete, si kufi ndarës me Hungarinë. Kështu, Bajaziti, e ndiente si nevojë të domosdoshme që në Ilirik, në pjesën më vitale, të ketë një aleat në politikën e tij aktive ushtarake, në kohën kur synonte principatat selxhuke-turke në Azinë e Vogël, stabiliteti i të cilave po ashtu ishte i rëndësishëm, për t’u përqendruar në drejtim të Perëndimit.<sup>640</sup>

Për këtë Bajaziti I u pajtua që të dy djemtë e princit tribal Lazarit, i cili u pre nga shpata e tij, të jenë udhëheqës të principatës rasiene dhe të sundojnë sipas ligjeve, traditave dhe zakoneve të tyre. Mirëpo ata detyroheshin t’i nënshtroheshin atij dhe të paguanin *xhizjen* (taksën e caktuar ndaj shtetit osman) dhe të kishin një numër të caktuar ushtarësh, në njësi të veçantë, që do të merrnin pjesë së

---

*gester der Kaiserurkunden des oströmischen Reiches von 565-1453*”, München-Berlin, 1965; Babinger, F: “*Geschihtsschreiber der Osmanen und ihre Werke*”, Leipzig 1927; Forretr, L: “*Handschriften osmanishscher Historiker in Instambul*”; Ferjanović B-Maksimovič, Lj: “*Vizantijci i turci u vreme Kosovske bitke*”, 1957; Хо-вакович, С: “*Србу и Турци XIV и XV века*”, Београд, 1960; Malcolm, Noel: “*Kosova një histori e shkurtër*”, Prishtinë 2002, faqe 63-69; Bastov, S: “*Die Türkischen Quellen des Laonikos Chalkandyrles*”, München 1960, faqe 34-42; dhe të tjerë, që hapjes së kësaj teze si dhe mbrojtjes së saj do t’i referohen me sjelljen e të birit të Lazarit, despotit Stefan, i cili qe ndër të parët që pranoi vasalitetin e Sulltanit dhe madje me njësitë e tij mori pjesë në betejat e ardhshme të Osmanëve kundër Hungarezëve dhe Polakëve. Ngjashëm do të shfrytëzohet edhe sjellja e Gjurad Brankoviqit kur do të sabotojë Betejën e Dytë të Dardanës, siç do të shfrytëzohet më vonë edhe sjellja e Kraleviq Markut.

<sup>638</sup> Më gjerësisht shih te Pulaha: “*Lufta shqiptare-turke*” dëshmitë e Neshrit dhe të tjerëve, faqe 55, 76,93; Babinger, F: “*Die Geschihtsschreiber der Osmanen und Ihre Werke*”, leipzig 1927.

<sup>639</sup> Shih autorin Bierman, Ralf: “*Lehrjahre im Kosovo*”, Bonn, 2006, ku sjellja vasale ndaj Sulltanit para betejës së Dardanës vlerësohet kështu: “*Sllavëve më kanosëse u dukej të pushtohen nga Hungaria katolike, se sa nga turqit myslimanë*”. Po ashtu rreth kësaj teme shih edhe relacionin e peshkopit të Tivarit, Guljem Adea “*Directorium ad passagium faciendum*”, i vitit 1332, drejtuar mbretit të Francës, Filipit VI Valua.

<sup>640</sup> Salabri, Muhamed Ali dr: “*Perandoria Osmane – faktorët e ngritjes së saj*”, Prishtinë, 2009, faqe 87.

bashku me ta (Osmanët) në Harujë. Sulltani, po ashtu u martua me vajzën e princit Lazar, Oliverën, e quajtur edhe Despina.<sup>641</sup>

Kjo krushqi u bë me miratimin e patriarkut dhe të klerit ortodoks dhe u dërgua në haremin e madh në Brusë, ku takoi bashkëshorte të panumërta me prejardhje fisnike, greke, franke dhe selxhuke.<sup>642</sup>

Stefani dhe Vuku u detyruan të paraqiteshin çdo vit në oborrin e Bajazitit dhe t'i shkonin në ndihmë me ushtri sa herë t'u kërkohej, siç bënin despot Konstantini, despoti Esau i Janinës, Angeli i Thesalisë dhe bashkëperandori i Bizantit, Manuel Paleologu.

Burimet e kohës bëjnë të ditur se Zigismundi i Hungarisë një pjesë të mirë të forcave të veta i kishte mobilizuar që të mbrohej nga “ekskursionet” e herëpashërshme të trupave osmane dhe rasiene, të cilat bashkërisht vepronin në pjesët kufitare. Bëhet e ditur se në vitin 1390, Pani i Severinit dhe Magjistari Ladislav zunë plaçkë në Branicevë flamurë osmanë dhe rasiianë.<sup>643</sup>

Sjellje të ngjashme zuri të tregonte edhe Vuk Brankoviçi, zotërimet e të cilit shtriheshin në pjesën nga Zveçani, Prishtina e deri në Shkup, gjë që nuk është e rastësishme që në burimet folklorike shqiptare njihet *Ujkan*, ndërsa në ato osmane (defterët *Vlk*), që i përgjigjet trajtës shqipe *Uk-Ujkan*. Pasi që nga Ragusa të ketë kërkuar azil për veten, gruan Mara dhe tre djemtë e tij (Gjuradin, Gjergjin dhe Lazarin, në rast se “do ta dëbonin Hungarezët ose Turqit apo dikush tjetër”) dhe do t'i jepet në maj të vitit 1390, Branku ua dorëzoi Shkupin Osmanëve, si dhe Zveçanin, Prizrenin dhe një pjesë të mirë të zotërimeve në këto anë.<sup>644</sup>

Kështu, qyteti i vjetër dardan, që vetëm para dy brezash kishe qenë pikënisje e pushtimeve rasiene kundrejt vendeve të Arbrit, si qendër e Bizantit, u bë një mbështetje kryesore e pushtimeve osmane kundër Veriut, por edhe Jugut.

Në këtë rrugë, më 1394, Osmanët u morën Gropajve Ohrin. Që ta dobësojnë pozitën e fisnikëve të Arbrit, që të shpronësoheshin sa më shumë që ishte e mundur, rrënuan thuajse të gjitha kështjellat që mbanin ata në këto anë (të Strugës, të Pogradecit e të Starovës). Osmanët u sollën kështu edhe gjatë pushtimit të Janinës, të Korçës dhe të Përmetit. Siç u tha edhe më parë, ky ndëshkim u vinte ngase ata për Osmanët shfaqeshin mosbesues, gjë që nuk vlente për princat tribalë,

---

<sup>641</sup> Po aty, faqe 87.

<sup>642</sup> Jiriček, Konstantin: “*Historia e Serbëve*”, pjesa e dytë, Tiranë, 2010, faqe 153.

<sup>643</sup> Po aty, faqe 153.

<sup>644</sup> “*Acta Albaniae*, II, 467, burime II, nr 131; Da Lezze: “*Historia turchesca*”, f.8; Jiriček, K: “*Historia e Serbëve*”, faqe 155.

sllavë dhe helenë, të cilët që nga fillimi kishin treguar prirje për lojëra të fshehta me Osmanët, që kishin shkuar në dobi të rrënimt të fuqisë së fisnikëve dhe feudalëve arbërorë.

Edhe pushtimet e tyre në Veri (nga Zveçani për në Shkodër e Ulqin, pastaj për në Dejë e Krujë), ndoqën thuajse të njëjtën mënyrë veprimi, por këtu Osmanët kishin parasysh ruajtjen e pasurive (minierave), të cilat duhej t'i shfrytëzonin për nevojat e tyre. Në kështjellën e Zveçanit, u vendos një "kefali" turk, ndërsa në minierën e hekurit në periferi të Rashës, u emërua kadiu i parë që ta mbikëqyrte dhe drejtonte atë.

Megjithatë, pushtimet osmane në Veri nuk kaluan pa vështirësi dhe pa konfrontime ushtarake, gjë që nuk kishte ndodhur në pjesët që zotëronte Vuku, për të cilin, siç u tha më herët kishte lidhur vasalitetet me Osmanët për të ruajtur zotërimet e tij në Dardani, por edhe pse fitonte peshë shumë më të madhe seç e kishte nën mbikëqyrjen e Rasianëve, sado që ky hesap nuk do t'i dalë, pasi që Osmanët për arsye të njohura që lidheshin me organizimin e pushtetit perandorak në pjesët e pushtuara, vendosën që nga vitit 1420 t'i shuanin që të gjitha lidhjet e tilla vasale në këtë pjesë.<sup>645</sup>

Kështu, Osmanët u desh të konfrontohen me Balshajt para se ta merrnin Ulqinin, ku ata kishin rezidencën e tyre si dhe Shkodrën. Bëhet e ditur se në vitin 1391 Gjergj Balsha kërkoi mbështetje nga Papa Bonifici IX, por kjo nuk i ndihmoi shumë. Meqë kishte rënë peng në duart e Bajazitit, do të lirohet një vit pasi që ai ta dorëzojë Shkodrën, Drishtin dhe portin e Shëngjinit.<sup>646</sup>

Fisniku tjetër, Dimitër Jonina, nuk ndoqi rrugën e Balshës. Pranoi vasalitetin osman dhe kështu ia doli të ruante zotërimet e tij midis Shkodrës dhe Durrësit, të cilat, për pushtuesit e rinj, kishin një rëndësi të madhe.<sup>647</sup>

Krahas Gjergj Balshës, që u detyrua dhunshëm të pranonte vasalitetin dhe Jonimës, i cili nëpërmes tij ruajti zotërimet e veta, ishin Dukagjinët (vëllezërit Progon dhe Tanush), të cilët, në verën e vitit 1393, Lezhën ia dorëzuan një admiral venedikas, i cili vendosjes së Osmanëve në Bunë, iu përgjigj me pushtimin e grykëderdhjes së Drinit.

---

<sup>645</sup> Shih: Fine: "Late Medieval Balkans", faqe 411-12; Ćirković: "Kosova u srednjem veku", faqe 45; Babinger, F: „Die Geschichtschreiber der Osmanen und ihre Werke“, Leipzig 1927; Emmert, T.A: „Serbian Golgotha: Kosovo, 1389“, New York, 1990.

<sup>646</sup> Më gjerësisht shih: Hamer, Jozef von: "Geschichte des Osmanischen Reiches", vëllimi II, faqe 175 dhe 183; Gelcich, Giuseppe: "Zeta dhe dinastia e Balshajve", Tiranë 2009, f.179-181;

<sup>647</sup> "Historia e Popullit Shqiptar" I, Tiranë 2002, faqe 377.



Kështu do të zgjasë deri në vitin 1402, kur pushtimet osmane në vendet e Arbrit ndalen për dhjetë vjet. Shkas për këtë ishte beteja e Ankarasë e atij viti, me ç'rast trupat osmane pësuan disfatë të thellë nga ushtritë mongole të udhëhequra nga Timurlengu. Në këtë betejë, me Bajazitin ishin edhe vëllezërit Stefan dhe Vuk Lazareviq dhe nipërit e tyre, vëllezërit Brankoviq, vasal të sulltanit.<sup>648</sup>

Pas vdekjes së Bajazitit I sapo i kthyer nga robëria njëvjeçare nga Timuri në Aksheher të Frigjisë së vjetër, për një dekadë të tërë Osmanët u përfshinë në një luftë të brendshme për fron të të bijve të sulltanit. Në atë luftë u përfshinë edhe vasalët e tyre: Lazareviqët në anën e Musait, ndërsa Brankoviqë në anën e Mehmetit I me nofkën “*kyrishxhi*” (mundësi), i cili nga Azia do t'i drejtohet pjesës europiane të Perandorisë, ku edhe do të dalë fitimtar, pasi që do ta vrasë vëllanë, Musanë në betejën Filipojës në korrik të vitit 1413.<sup>649</sup>

Nën drejtimin e Mehmetit I (1413-1421), Osmanët sërish iu kthyen Ilirikut për të vazhduar ku kishte mbetur Bajaziti I. Mehmeti I, i këshilluar nga ndihmësit e tij kryesorë në Ilirik, Brankoviqët dhe feudalët tjerë ortodoksë, që e ndiqnin atë, e kishte të qartë se vendet e Arbrit duhej paqësuar në tërësi, meqë ato kishin një pozitë të rëndësishme për krijimin e kohezionit të brendshëm antiosman në Ilirik siç kishin edhe aftësi dhe prirje për lidhje me perëndimorët, me të cilët mund të lidhnin aleanca për t'u kthyer në mbështetës të tyre në këtë pjesë. Kjo, Osmanëve, do t'ua rrezikonte qëllimet që kishin drejt Europës Qendrore.

Se disa nga Arbrit ishin në gjendje që gjërat t'i ndryshonin ashtu që të mos u shkonin përshtati Osmanëve, kjo tashmë ishte parë gjatë dekadës së krizës që kishte përfshirë Osmanët pas humbjes nga Timurlengu, kur ata kishin filluar t'i zgjerimin feudet e tyre, siç ishte rasti i Niketas Thopias, i cili, pas fundit tragjik të Konstantin Balshës, kishte vënë në zotërim pronat e tij, që si vasal i venedikasve zotëronte Krujën (1402-1415). Po ashtu në Mat, shfaqej feudali Gjon Kastrioti, i cili ia kishte dalë që brenda një kohe të shkurtër të bëhej zot i tokave nga kepi i Rodit në Durrës, Lezha dhe Shkodra si dhe të mbikëqyrte rrugët për në Prizren dhe Shkup. Si qytetar i Venedikut dhe Raguzës, si shumica e fisnikëve dhe feudalëve arbërorë të Veriut, Gjon Kastrioti, lëkundej midis dy kishave, asaj katolike dhe ortodokse, me të cilat mbante lidhje të mira. Kështu, krahas mbështetjes klerikëve dhe abacive katolike, njëherësh me dhurata

---

<sup>648</sup> Më gjerësisht shih: Chalconcandylae, Leonici: “*Historiarum Demonstrationes*”, ed. S. Darko, Budapestini, 1922; Giese, F: “*Die Altosmanischen Anonymen Chroniken*”, II, Leipzig 1925; Kandić, J: “*Despot Stefan Lazarević i turci*”, Beograd, 1982 Inhlxhik, Halil: “*Perandoria Osmane – periudha klasike 1300-1600*”, Shkup, 2010.

<sup>649</sup> Inhlxhik, Halil: “*Perandoria Osmane – periudha klasike 1300-1600*”, Shkup, 2010.

mbulonte edhe manastiret e Hilandarit me të cilin kishte edhe lidhje të hershme.<sup>650</sup>

Gjon Kastrioti, në fillim ishte vasal i Venedikut, por shpejt iu desh t'u nënshtruhej Osmanëve (1410),<sup>651</sup>të cilët, sapo iu kthyen Ilirikut, vunë në shënjestër princat arbërorë dhe lidhjet e tyre me Venedikasit dhe Perëndimin. Kështu, Mehmeti I, duke ruajtur aleancën me princat ortodoksë (hasianë, bullgarë dhe grekë), të cilët jo vetëm që i kishte vasalë të besueshëm, por edhe bashkëveprues në të gjitha fushatat kundër Hungarezëve, Bosnjës dhe të tjerëve, nuk e kishte të vëshitirë që edhe princat dhe feudalët arbërorë t'i fusë në radhën e vasalëve. Tek e fundit, edhe arbërorët ishin pjesë e kozmosit të paqëndrueshëm politik të Bizantit.

Në këtë fushatë, krahas nënshtrimit të Arbërve, Mehmeti I kishte parasysh që edhe më tutje t'i forconte aleatët dhe vasalët kryesorë, Rasianët pa përjashtuar këtu edhe Paleologun dhe Grekët. Kështu, Mehmeti I, despotit Stefan ia dhuroi Koprianin në Nish, krahinën Znepolje në Tërë, në malet midis Nishit dhe Sofjes dhe disa pjesë të tjera. Po kështu perandorit vasal të Bizantit, Manuel iu kthyen qytetet e marra prej Musait.<sup>652</sup>

Edhe midis Rasianëve dhe Grekëve u krijuan lidhje edhe më të ngushta. Nipi i despotit, Gjergj, u martua për të satën herë me Irenën nga familja e Kantakuzenëve. Kështu, Grekë të panumërt hynë në shërbim të Rasianëve, ndër të cilët edhe vëllai i Irenës, Tomas Kantakuzeni.<sup>653</sup>

Por, dinastët ortodoks rasianë, që tashmë ishin mbështetësit kryesorë të Mehmetit I dhe dora e djathtë e tij, po ashtu ishin të interesuar që fushata osmane, krahas rrënimit të fisnikëve dhe feudalëve arbërorë, që tashmë ishin forcuar, të rrënonin edhe aleancat e tyre me Venedikun, ose që kur kësaj nuk i dillej, atëherë ata të shfaqeshin mbikëqyrës të këtyre aleancave, gjë që kishin edhe përkrahjen e Osmanëve, të cilët aleatët e tyre rasianë, tashmë i kishin kthyer në partnerë kryesorë në Ilirik.

Në këtë mënyrë, Osmanët vepruan në Novobërdë. Në vitin 1412 e sulmuan atë dhe e mbajtën të rrethuar, por së fundit ia lanë në pronësi një pinjoll të familjes së Lazarit. Me vdekjen e Niketë Thopisë, në fillim të vitit 1415, Osmanët pushtuan Krujë. Gjatë vitit 1417 i morën Beratit Teodor Muzakës dhe Ka-

---

<sup>650</sup> Jireček, Konstantin: "*Historia e Serbëve*", libri i dytë, Tiranë, 2010, faqe 173.

<sup>651</sup> Shih: Thallozy – Jireček: "*Zwei Urkunden aus Nordalbanien*", Arch. Slav. Phil. 21, 1899.

<sup>652</sup> Schreiner, P: "*Die Byzantinischen Kleinkroniken und die Anastik beri den Südslaven*", Bulgarian Historicval Rewiew 6-1978, faqe 45-54.

<sup>653</sup> Më gjerësisht shih: Serb. Annalen, Glasnik 53, 80; dhe Новакович, С: "*Србу и Турци XIV и XV века*", Београд, 1960.

ninën bashkë me Vlorën Rugina Balshës. Kurse në vitin 1418, pushtuan Gjirokastrën, qendrën e Zenebishëve.<sup>654</sup>

Këto pushtime u bënë në kohën kur Mehmeti I, edhe pse pësoi humbje nga venedikasit në një betejë detare para Galipolit (1416) dhe u detyrua të bënte një paqe me ta. Kjo len për të kuptuar se Osmanët kishin arritur një marrëveshje me venedikasit rreth shtrirjes së tyre në viset e Arbrit, me ç'rast ata do të mbanin pjesët në brendi, ndërsa venedikasit qytetet breg-detare.

Pinjulli i fundit i familjes Balsha, i cili tashmë kishte humbur shumë nga zotërimet, nën mbështetjen e dajës, despotit Stefan Lazareviq dhe njerikut Sandaljit, u hodh në luftë kundër Venedikasve, të cilët u përfshinë në një luftë për zgjerimin e pushtimeve në Adriatik me Zigismundin e Hungarisë, me ç'rast Hungarezët dolën humbës, ndërkohë që Republika e Adriatikut u vendos në Split, Trogir dhe në ishujt Braç, Korçula dhe Lesina në mënyrë që kështu të fusë nën mbikëqyrje edhe Kotorin.<sup>655</sup>

Balsha u detyrua të sulmojë Venedikun pas shtatë vjetësh dhe të rrethojë kështjellën e Drishtit. Venedikasit u kundërpërgjigjën me pushtimin e Budvës. Kështu, lindi nevoja për bisedime paqësore, por ato, siç ishin paraparë nga despoti, Stefan Lazareviq, të cilin Balsha që nuk kishte djalë, e kishte caktuar si trashëgimtar, do të zhvillohen pa Balshën dhe nën drejtimin e Rasianëve, pasi që Balsha i sëmurë, vdiq më 28 prill 1421 dhe u varros solemnisht nga Stefani.<sup>656</sup>

Vdekja e Balshës sikur i dha fund lavdisë së njërës ndër dyert më të fuqishme princore arbërore nga veriu, e cila për më shumë se gjysmë shekulli ishte e pranishme në një skenë politike ku kryqëzoheshin interesat e Bizantit dhe të Perëndimit në njërën anë dhe ato me Osmanët në tjetrën anë.

Edhe pse Balshajt nuk ia dolën që të përballojnë sfidat e kësaj përpëlitjeje ndër më të mëdhatë e kohës, megjithatë me veprimet që të luhet nga njëra anë në tjetrën, qoftë edhe si humbës, ia dolën që faktorin arbëror, ta fusin në një lojë të madhe, në të cilën, feudalët dhe princat tjerë, kush më shumë e kush më pak, u përfshinë në të. Dhe kjo do të paraqesë aktin e fundit të një ndeshjeje historike që do t'i paraprijë pushtimit shumëshekullor osman.

Ky akt, të cilit, vulën e fundit do t'ia japë Sulltan Mehmeti II pushtuesi pak më vonë, do të pasohet nga Murati II, që erdhi në pushtet pas vdekjes së të et,

---

<sup>654</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i parë, Tiranë, 2002, faqe 377.

<sup>655</sup> Gelcich, Giuseppe: “*Zeta dhe dinastia Balshaj*”, Tiranë 2029, faqe 173-170.

<sup>656</sup> Shih: Stanojević: *Arch. Slav. Phil.* 18 (1896), 459; Gelcich, Giuseppe: “*Zeta dhe dinastia e Balshajve*”, Tiranë 2009, faqe 322-341; K. Jireček: “*Historia e Serbëve*”, libri i dytë, Tiranë, 2010, faqe 186.

Mehmetit I (1421). Murati II, i bindur se beteja vendimtare për të depërtuar tutje në Perëndim duhej të kalonte nëpër Arbëri, u vu vetë në krye të fushatës ushtarake, ndër më të mëdhatë e kohës. Ushtria e tij komandohej nga gjenerali i sprovuar Isa Bej Evrenozi. Pas disa luftimeve, me humbje të dyanshme, Osmanët fituan. Kjo bëri që në pjesët e jugut të vendosej regjimi i timareve, me çka i jepej fund autonomisë së deriatëhershme feudale, që kishte karakterizuar rrethanat bizantine, mbi të cilat ishin ngritur edhe feudet dhe principatat e pavarura jo vetëm te Arbrit, por edhe në pjesët e tjera.<sup>657</sup>

Rrënimi i principatave të pavarura të Arbrit (Balshajve, Thopijave dhe Muzakave), megjithatë, u përcoll me ngritjen e të tre zotimeve të tjera të mëdha feudale: të Dukagjinëve, Arianitëve dhe Kastriotëve. Këto zotime përfshinin krahina malore dhe në gjirin e tyre kishin një popullsi me tradita të lashta luftarake, ku bujkrobërit përbënin pakicën, kurse shumicën dërmuese e formonin fshatarët e lirë, të cilët nuk i njihnin marrëdhëniet feudale dhe kishin gjetur një modus vivendi me bujarët vendorë.<sup>658</sup>

Si rrjedhim, fshatarët e lirë të Arbërisë ishin më të interesuar se bujkrobërit të luftonin kundër invazionit feudal-ushtarak.<sup>659</sup>

Edhe Dukagjinët, Arianitët dhe Kastriotët me zotimet e tyre, ndonëse do të kalojnë nëpër një fazë kur Osmanët tashmë ndodheshin në procesin e mbylljes së vasalitetit dhe të vendosjes së pushtetit të plotë, u përpoqën që të përfitojnë edhe nga rrethanat e tilla, të cilat ishin jo premtuese. Atyre nuk u ndihmoi as “arti” i përpjekjeve të lidhjeve të vazhdueshme me perëndimorët (veçmas me Venedikun), të cilët përfitonin edhe në këto rrethana.

Megjithatë, nga gjithë kjo, Dukagjinët ia dolën që të ruajnë disa zotime “të pavarura” në pjesët malore të veriut, nën emrin “Krahina e Dukagjinit” në Dardaninë antike. Ngjashëm ndodhi edhe me Arianitët, të cilët humbën shumë nga zotimet por, ruajtën namin e fisnikërisë, që do të bartet edhe më vonë në kujtesën historike nga kronika të jashtme.<sup>660</sup>

Ngjashëm ishte edhe me Kastriotët dhe zotërimet e tyre, që sado të rrudhura, do të zënë vend kyç në historinë e Arbërve dhe të Arbërisë në saje të ngjarjeve që

---

<sup>657</sup> Shih: Inxhik, H: “*Suret-i Defter-i Arvanid*”, Ankara, 1954; Fashëri, Kristo: “*Skënderbeu*”, Tiranë 2002, faqe 45.

<sup>658</sup> Shih: Fashëri, Kristo: “*Skënderbeu*”, Tiranë 2002, faqe 46.

<sup>659</sup> Më gjerësisht: Inxhik, H: “*Suret-i Defter-i Arvanid*”, Ankara, 1954.

<sup>660</sup> Rreth Arianitëve dhe historisë së tyre shih gjerësisht te Babinger, Franz: “*Fundi i Arianitëve*”, Tiranë 2004; “*Kronika e Gjon Muzakës*” te Xhufi, Pëllumb: “*Nga Paleologët te Muzakajt*”, Tiranë 2009, faqe 365-457.

në atë trevë do ta kenë nga viti 1443, kur aty do të zë fill epopeja e lavdishme skënderbegiane.

Fushata për nënshtrimin e Arbërve do të ishte jo e plotë pa fundin e Dardanisë, pjesës kyçe që lidhte lindjen me Perëndimi, ku gjendeshin edhe xeheroret e shumta. Atje, nën drejtimin e mbetjeve të fundit të despotëve të Rashës dhe me ndikimin e tyre do të vendoset edhe fati i një pjese të madhe të Dardanisë, që Osmanët ua kishin lënë aleatëve të tyre, Brankoviçëve (Vukut) në përbërje të despotatit të tij që kishte pranuar vasalitetin osman, prej tyre i quajtur *Vlk-oglu*.<sup>661</sup>

Megjithatë, në këto vende, që kishin një rëndësi të veçantë ekonomike, pasi që në to gjendeshin minierat e njohura të Novobërdës dhe Zveçanit, gjatë viteve 1394-1444, Osmanët vendosën nëpunësit dhe ushtarët e tyre për t'i mbikëqyrur prodhimet e tyre, të cilat nuk mund të shkonin, si më parë në drejtim të Raguzës apo Venedikut, por t'i dorëzoheshin arkës së shtetit osman. Në këto pjesë, deri sa do të bëhet pushtimi përfundimtar nga Osmanët, në vitin 1455, "bashkëjetonin" pushteti vendor i Vukut (*Vlk-oglut*) me atë osman, por ky i fundit kishte fjalën kryesore.<sup>662</sup>

Pjesa më e madhe e Dardanisë, në veri të Shkupit dhe të Tetovës, ra nën sundimin osman në kohën e Sulltan Mehmetit II Pushtuesit (1451-1481). Natyrisht, cak i pushtimeve osmane ishin xeherorët e njohura të Novobërdës, Zveçanit dhe të Gllahovicës (kjo e fundit e pasur me hekur). Disa burime bëjnë të ditur se "sulltani kishte grumbulluar ushtrinë islame dhe ishte nisur në luftë të shenjtë nga Shkupi, prej nga do të kalojë kah mali Kara Tonlu (Karadaku i Shkupit) për në Novobërdë. Novobërda, të cilën xehetarët sasë e quanin *Neuberger*, ndërsa Italianët *Novomonte*, kishte një kështjellë të fortë dhe disa vendbanime xehetarësh përreth. Aty gjendej kolonia kryesore e raguzianëve, por banohej edhe nga Italianët, sidomos venedikasit. Aty banonin edhe shumë bujarë vendorë, të cilët prej andej mbikëqyrnin nxjerrjen e xeheve dhe përpunimin e tyre, por edhe dërgimin në vendet e tjera.

Meqë këto xeherore ishin të rëndësishme, sulltani kishte vendosur që t'i vinte nën mbikëqyrje të plotë, kështu që këtë duhej ta bënte me ushtri, edhe pse

---

<sup>661</sup>Historianët turq: Sadedini, Neshri dhe Ashikpashazade në kronikat e tyre flasin për "*Vilajetin Vlk*" dhe vasalin *VLK-oglu*, të cilët historiografia serbe e shekullit XIX i fikson si Lazareviq dhe Brankoviq, sidomos këtë të fundit, me ç'rast "*Vilajetin VLK*" (Kosovën), e quan "*Oblast Brankoviqa*", që po të zërthet gjuhësisht "*Vlk*" do të thotë "*Ujk*" ose "*Ukë*", që i përgjigjet patronimit "*Ujkan*", të përhapur në gjuhën shqipe. Rasti i "*Vilajetit VLK*" dhe emërtimi i tij "*Oblast Brankoviqa*", duke e përkthyer emrin "*Ujk*" ose "*Ukë*" në "*Vuk*", tregon më së miri përmasat e falsifikimit të historiografisë serbe për ta sajuar me çdo kusht të ashtuquajturin shtet mesjetar serb me qendër në Kosovë me "despotë serbë", gjoja të legjitimuar edhe nga osmanët, kur e gjitha flet për një feudal vendor, ortodoks, nga shumë burime të kohës i cilësuar si tribal, emri i të cilit shpjegohet me gjuhën shqipe! (Shih te Nikolić, Maja: "*The byzantine Writers on Serbia 1402-1439*", Beograd, 2010, faqe 41).

<sup>662</sup>Më gjerësisht: K. Jiriček-J. Radonić: „*Istorija Srba*“, I, Beograd, 1952, faqe 369,422.

bujarët vendorë edhe më tutje dëshironin t'u përmbaheshin marrëveshjeve që kishin lidhur me Osmanët në vitin 1441 për shfrytëzimin e përbashkët. Isa-beu, i cili me një pjesë të ushtrisë kishte arritur përpara sulltanit aty, thirri komandantin vendor që të dorëzohej me vullnet. Pasi kjo nuk u bë, sulltani u nis vetë me pjesën tjetër të ushtrisë të sulmojë Novobërdën. Menjëherë filloi rrethimi, që zgjati dyzet ditë. Pas disa bombardimeve, kur po rrënoheshin muret mbrojtëse të kështjellës, më një qershor 1455, qyteti u dorëzua. Një pjesë e mirë e parisë së qytetit u shua, ndërsa një pjesë e të rinjve, 320 sish, u morën për jeniçerë.<sup>663</sup>

Thuhet se aty osmanët kishin gjetur thesar të shumtë (sasi e madhe e argjendit) që e ruante i biri i Vukut, thesar ky që ishte dërguar në arkën e Stambollit.<sup>664</sup>

Rënia e Novobërdës, që merrej si fortesë e botës së krishterë katolike, në Itali dhe në Hungari u prit me përshtypje të hidhura. Despot Gjurgj Brankoviçi mësoi lajmin e humbjes më 21 qershor në Hungari, në tubimin e bujarëve në Rab, ku përgatiteshin plane të mëdha për një fushatë të forcave të krishtera kundër Osmanëve.<sup>665</sup>

Pa çarë kokën se çfarë kishin ndërmend të krishterët, Sulltan Mehmeti me forcat e tij kishte vazhduar në drejtim të kështjellës së Trepçës, e pushtuar pa ndonjë mund të madh. Edhe aty ishte gjetur pasuri e madhe. Me Trepçën ishin pushtuar edhe xeheroret e tjera të argjendit. Pasi që kishte qëndruar për pak kohë në (shehittlëk) - vendin ku ishte vrarë Sulltan Murati I, Sulltani Mehmeti ishte kthyer në Selanik dhe prej andej në Edrene.<sup>666</sup>

## RRËNIMI I PRINCIPATAVE TË ARBËRIT DHE SANXHAQET OSMANE

Edhe pse vendosja e pushtetit osman në Arbëri do të kalojë nëpër disa faza - nga ajo e vasaliteteve - në vitet 1371, 1385 dhe 1389 e deri te pushtimet e para midis viteve 1412-1420, për të vazhduar me ato të viteve 1445-1456, që të përmbillet me rënien e Shkodrës më 1479 – ajo rrënoi princat arbërorë (Kastriotët, Dukagjinët, Jonimet, Arianitët e të tjerë), si dhe zotimet e tyre nga feudet e deri te principatat e pavarura, që ishin pjesë e realiteteve të atëhershme politike të

<sup>663</sup> Babinger, Franc: *“Mehmet Pushtuesi dhe koha e tij”*, Prishtinë, 1989, faqe 145.

<sup>664</sup> Rizaj, Skënder: *“Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVIII”*, Prishtinë, 1982, faqe 20.

<sup>665</sup> Zachariadou, E.A: *„Süleman çelebi in Rumili and dhe Ottoman chronicles“*, Der Islam, 60/ 1983, faqe 269-296 dhe Babinger, Franc: *“Mehmet Pushtuesi dhe koha e tij”*, Prishtinë, 1989, faqe 146.

<sup>666</sup> Po aty, faqe 20.

Bizantit në shturje, të cilat ia lëshuan vendin sistemit timar me të cilën rrënjësisht ndryshohej struktura e pronës.

Ngjashëm ndodhi edhe në Dardani dhe Epir, ku heqja e pushtimit të dinastisë tribale të Nemanjajve të Rashës dhe mbetjet e tyre (Lazareviqet, Brankoviqet dhe të tjerët), u përcoll me rrënimin e tyre.

Pushtimet osmane, të cilat u dhanë fund principatave vasale si dhe vasalitetit, u përcollën edhe me vendosjen e aparatit shtetëror osman, i cili mbështetej mbi pronën feudale ushtarake, e njohur si sistemi i *timarit*. Kjo lloj prone, me shumë ngjashmëri me atë të Bizantit, mundësonte mënyrën e re të qeverisjes mbi të cilën Osmanët ndërtonin sistemin e drejtimit, atë të mbrojtjes, të prodhimit por edhe të vjeljes së taksave, të cilat ishin bazë e të ardhurave të shtetit.<sup>667</sup>

Fillimisht, mund të thuhet se rregullimi administrativ i Perandorisë Osmane, ishte në përputhje me zgjerimin territorial të Perandorisë, që kishte pësuar ndryshime të ndjeshme nga koha kur Osmanët, nga fuqia lindore, pas kapërcimit në pjesën e Ilirikut, fillojnë të zgjerojnë pushtimet në pjesët e tjera perëndimore. Shteti osman ndahej në disa njësi territoriale-politike: në *sanxhaqe*, të cilat ndaheshin në njësi më të vogla - *kaza*. Në kohën e Muratit I u formua edhe *elajetia* po *bejlerbejllëku* si njësi e madhe e Perandorisë. Në fillim ishin vetëm dy prej tyre, ai i Rumelisë, i cili u formua rreth vitit 1362. *Elajetii* Anadulli u krijua më 1393. Qendra e Elajetit të Rumelisë (nga fjala *rum* - i krishterë), ishte Edreneja, pastaj Galiopola dhe Pllovdivi. Prej shekullit XV qendra e *elajetit* kaloi në Sofje, e më vonë në Manastir.<sup>668</sup>

Ani pse ekzistonte ideja e formimit të një perandorie centraliste osmane, krahinat e pushtuara, varësisht nga tiparet e veta, janë rregulluar në forma të ndryshme. Pranë *elajeteve* gjendej edhe forma administrative "*hykymetler*"- *territore vetëqeverisëse në baza fisnore* me në krye prijatarët e fisit (*ahiret*).<sup>669</sup>

Sipas këtij parimi edhe malësitë e Arbrit gëzonin autonomi të brendshme. *Kanunnamet* osmane bëjnë të ditur se "bajraktarët kurdë, arbër, dhe arabë ishin të

---

<sup>667</sup> Më gjerësisht rreth sistemi timar, buxhetit të shtetit si dhe të drejtës juridike shih: Georgieviz, Barth. "*De turcarum moribus*", Helmestaddi, 1671; d'Ohsson, M: "*Tableau gjeneral de l'Empire Othoman*", Paris, 1824; Urquhart: "*Turkey and its resources*", London, 1833, faqe 17-20; Barkan, Ö. L: "*The Ottoman Budgets*" (Revue de la Fakulte des Sciences Econ. De l'Univer, d'Istanbul, vëll, XVII/1955-6, faqe 193-346); Hamer von Josef: "*Des Osmanischen Reiches Staatsverfassung und Staatsverwaltung*", Wien 1815, faqe 309, 407 dhe 413; P. Hoster, P: "*Zur anvendung des islamischen Rechts im 16 Jh. Die juristischen Darlegungen (ma'ruzai) des Schejch ül-Islam Ebu Su'üd (ges.1574)*", Stuttgart, 1935; Inalcik, H: "*Land Problems in Turkish History*", Muslim World, vëll, 45 (1955).

<sup>668</sup> Rizaj, Skënder: "*Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*", Prishtinë, 1982, faqe 41.

<sup>669</sup> Shih Hamer, Joseph von: "*Das osmanischen Reichs Sraatsverfassung und Staatsvewaltung*", vëll. II Vjenë 1815; Rizaj Skënder: "*Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*", Prishtinë 1982, faqe 42.

sigurt dhe të pavarur, por ata ishin shumë të varfër dhe të fuqishëm, ndërsa vojvodët e Vllahisë dhe të Molldavisë nuk ishin të sigurt dhe aq të pavarur”.<sup>670</sup>

Edhe Mali i Zi ishte organizuar si njësi territoriale-politike autonome me përbërje fisnore nën mbikëqyrjen e sanxhakut të Shkodrës dhe të Dukagjinit. Quhej *Vilajeti Karaca Dag*, e ndahej në 9 nahije.<sup>671</sup>

Krahas njërive autonome si dhe statusit të tyre në përputhje me rrethanat, ku rëndom kihej parasysh karakteri etnik si dhe traditat e caktuara kulturore dhe historike, ishin edhe ato kishtare, të cilat jo vetëm që mbroheshin me vendime të veçanta perandorake “*Beratet*”, që i nxirrte sulltani, por gëzonin edhe privilegje dhe të drejta të shumta, që në disa raste, shkonin edhe deri te statusi i eksteritorialitetit, siç e kishte Qendra e Patrikanës Ortodokse në Kostandinopojë (Stamboll) dhe Mali i Shenjtë në Artos (Hilandar) të Greqisë.<sup>672</sup>

Këtë status, që mund të krahasohet me “shteti në shtet” me 200 priftërinj në njëzet kisha të popujve të ndryshëm,<sup>673</sup> kisha ortodokse e fitoi në një marrëveshje të lidhur me sulltan Mahmudin II pas rënies së Kostandinopojës më 1453.

Duke e parë rëndësinë e kishës ortodokse si dhe përfitimet që mund të kishte prej saj, sulltani nxitoi që Kishës Ortodokse t’ia konfirmojë statusin që kishte gjatë perandorisë së Bizantit. Në këtë mënyrë, sulltani ia doli që kishën bizantine ta kthejë në një aleate të fortë. Me rastin e kësaj marrëveshje, Kisha Ortodokse, siguroi privilegje të shumta, ndër të cilat, më e rëndësishmja ishte ajo që kishte të bënte me atë se përkatësia e krishterë identifikohet me etninë e krishterë, me çka kisha merrte përsipër përkujdesjen shpirtërore mbi të gjithë besimtarët e krishterë dhe në kuadër të kësaj, edhe një mbikëqyrje shoqërore, ngaqë autoriteteve kishtare në nivelet vendore u lejohej organizimi i administratës së besimtarëve të krishterë (rajës) në shumë fusha të jetës si dhe e drejta e liturgjisë dhe e shkolimit kishtar (liturgjisë) në gjuhën amtare. Me këto të drejta, në njëfarë mënyre, organizimi kishtar kishte tretmanin e një pushteti paralel vendor, të ngjashëm si në kohën e Bizantit, faktor ky që në shekullin XIX do të shfrytëzohet për lëvizjet

---

<sup>670</sup> Albert Howe Lybyer: “*The Government of the Ottoman Empire in the time of Suleiman the Magnificent*”, Cambridge Harvard University Press London, 1913, faqe 297 dhe Rizaj, Skënder: “*Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*”, Prishtinë, 1982, faqe 42; Stadtmüller, G: “*Osmanische Reichsgeschichte un balkanische Volksgeschichte*”, Leipziger Viertelsj. Für Südosteuropa, nr. 3/1939, faqe 1-24.

<sup>671</sup> Đurđev, B: “*Turska vlast u Crnoj Gori u XVI i XVII veku*”, Sarajevë, 1959, faqe 95.

<sup>672</sup> Organizimi kishtar në Malin e Shenjtë në Atos (Hilandar) është quajrut “republikë e priftërinjve”. Si e tillë është pranuar qysh në vitin 1430 kur Osmanët pushtuan Selanikun. (Shih: Villemain: “*Essai historique sur l’etat des Grecs depuis la conquete jusqu’anos jours*”, Paris, 1825 dhe Gelzer, H: “*Vom Heiligen Berge*”, Leipzig, 1904, faqe 25.

<sup>673</sup> Novaković, Stojan: “*Tursko carstvo pred srpski ustanak 1780-1804*”, Beograd 1906, faqe 263.



nacionale të të krishterëve të ritit lindor mbi baza fetare në përputhje me përkatësinë e gjuhës liturgjike (greke, bullgare dhe sllave).

Edhe pse, në kierakinë e Patriarkanës së Kostandinopojës rëndom drejtonin patriarkët grekë, të cilët, do të përpiqen që t'ia ruajnë edhe karakterin grek ortodoksisë, megjithatë përfitime të mëdha nga autoqefalia osmane e kishës do të kenë edhe ato bullgare, ruse dhe sidomos serbe, të cilat, nga fundi i shekullit XIX e kënde, nën trysinë e pansllavizmit rus dhe të drejtës së fituar nga Rusia në Konferencën e Paqes në Paris të vitit 1856 të mbikëqyrjes për të krishterët ortodoksë të pjesës evropiane, identitetin kishtar do ta përkthejnë në atë nacional.<sup>674</sup>

Krahas territoreve autonome dhe atyre kishtarë, pushteti osman, në hapësirën mesjetare të Dardanisë, Maqedonisë dhe të Epirit, të njohur si Arbëri, në periudha të ndryshme të shekullit XV, krijoi disa sanxhaqe: pashasanhaku i Shkupit me 344 timare, sanxhaku i Vuçitërnës me 317 timare, sanxhaku i Prizrenit me 225 timare, sanxhaku i Shkodrës, sanxhaku i Dukagjinit me 53 timare, sanxhaku i Elbasanit me 138 timare, sanxhaku i Ohrit me 342 timare, sanxhaku i Vlorës me 439 timare, sanxhaku i Prevezës, sanxhaku i Janinës, sanxhaku i Arbrit (*Sancak-i Arvanid*), e të tjerë.<sup>675</sup>

*Sanxhaku i Shkupit* shfaqej më i rëndësishmi, sepse kishte 22 nahije me një shtrirje shumë të gjerë: nga Selaniku në lindje dhe arrinte në perëndim deri në Gostivar e Kërçovë. Pas tij vinte sanxhaku i Arbrit (*Sancak-i Arvanid*, me kryeqytet Gjirokastrën. Shtrihej nga Çamëria deri në lumin Mat. Ai bënte pjesë në *Elajetin* e Rumelisë. Sanxhaku i Arbrit ishte i ndarë në njësi të vogla, ku përfshiheshin disa krahina (*nahije*).<sup>676</sup>

Në krye të sanxhakut qëndronte *sanxhakbeu*, i cili ishte komandant i ushtrisë së sanxhakut, që formohej nga disa qindra *spahinj*. Në krye të vilajetit ishte *subashi*, komandant i spahinjve që kishin *timarët* në vilajetin përkatës. Në çdo vilajet, pranë *subashëve* ishin *kadilerët*, kryetarë të zyrave të Sheriatit (Ligjit të Shenjët), të cilët kryenin detyra administrative, civile, gjyqësore dhe fetare. Pranë kadilerëve kishte edhe drejtues të tjerë të administratës shtetërore osmane. Këta ishin *naivët*, zëvendësit e kadilerëve, dhe *imamët*, funksionarët e kultit osman. Në çdo qytet ishte edhe *dizdari*, komandant i rojeve të kështjellës. Të gjithë ata ishin të pajisur me *timarë*. Popullsia jomuslimane (e krishterë) cilësohej *raja* (e nënshtruar).<sup>677</sup>

---

<sup>674</sup> Јастребов, И. С: „Лодаци за историју српске цркве“, Београд 1879, фаце 1-27.

<sup>675</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëllimi i parë, Tiranë, 2002, faqe 379.

<sup>676</sup> Po aty, faqe 379.

<sup>677</sup> Po aty, faqe 380.

Kur jemi te *raja* dhe tretmani i saj në Perandorinë Osmane, atëherë çështja çon te parimet themelore mbi të cilat mbështetet origjina e shtetit osman ndër të cilët ideali i *luftës së shenjtë* ishte faktor i rëndësishëm për themelimin dhe zhvillimin e shtetit osman. Sepse, principata e parë osmane, e cila u themelua në vitin 1302, (pas fitores ndaj ushtrisë perandorake në betejën e Nikesë, kur edhe do ta pushtojë ish kryeqytetin e Bizantit), në tërësi u mbështet mbi parimet e *darulislamit* (botës së Islamit). Zgjerimet dhe pushtimet osmane në drejtim të Perëndimit bëheshin me moton se *bota duhej kthyer në një perandori islame*. Por *lufta e shenjtë*, që u zhvillua me shumë sukses nga Osmanët, nuk kishte për qëllim ta shkatërronte, por ta nënshtrohte botën e të pabesëve, *darulharb*. Kështu, Osmanlinjtë e themeluan perandorinë e tyre duke e bashkuar nën sundimin e tyre Anadollin mysliman me Ilirikun e krishterë, ndërsa edhe pse *lufta e shenjtë* e vazhdueshme ishte parim themelor i shtetit, Perandoria paraqitej, në të njëjtën kohë, edhe si mbrojtëse e Kishës Ortodokse dhe e miliona të krishterëve ortodoksë.<sup>678</sup>

Islami garantonte jetën dhe pronën e të krishterëve ortodoksë dhe të çifutëve, me kusht që ata të ishin të dëgjueshëm dhe të paguanin taksë për kokë banori. U lejonte ta ushtronin fenë e të jetonin sipas ligjeve të tyre fetare. Gjatë viteve të hershme të Perandorisë, Osmanlinjtë ndoqën një politikë të përpjekjes për të siguruar nënshttrimin dhe besimin vullnetar të të krishterëve para se të vinte puna për luftë.<sup>679</sup>

Pasi Osmanët kaluan Bosforin në vitin 1326, nuk do të ketë nënshtime “vullnetare”, siç kishte ndodhur në disa krahina kufitare kur Mihali Gazi, një feudal i kufirit grek kishte pranuar islamit dhe kishte bashkëpunuar me Osmanët.<sup>680</sup>

Megjithatë, asaj që më vonë do të kthehej në nënshtim me luftë, do t'i hyjë në mes periudha e vasalitetit, që paraqiste njëfarë uverture për pushtimet e mëvonshme. Vasaliteti kthehet në një dukuri të përgjithshme në Ilirik pas Betejës së Maricës, të vitit 1371, kur njëri pas tjetrit princat e Ilirikut u detyruan të pranonin nënshttrimin osman. Që të kthehet në një realitet shoqëror dhe politik, kësaj do t'i ndihmojë edhe sjellja e perandorit të Bizantit, Paleologut, që kërkoi mbështetjen e sulltanit për ta mbrojtur fronin.

Meqë Osmanlinjtë i respektonin parimet e feudalizmit, kjo bëri që ata nga vasalët e tyre, në fillim të kërkonin vetëm një haraç të vogël vjetor, si shenjë të nënshtimit ndaj shtetit islam, gjë që nuk dobësoi pozitën e tyre materiale. Por,

<sup>678</sup> Inalxhik, Halil: “Perandoria Osmane”, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2010, faqe 19.

<sup>679</sup> Po aty, faqe 19.

<sup>680</sup> Po aty, faqe 19.

me kohë, kur pushtetit osman do t'i duhej gjithnjë e më shumë taksa për t'i mbuluar shpenzimet e shtetit në rritje që u duheshin fushatave ushtarake në Perëndim dhe Lindje, princat vasalë filluan të ndjehen gjithnjë e më të shtrënguar të kundërshtonin, gjë që më vonë do të çojë te konfliktet e njohura me Perandorinë Osmane. Sulltan Mehmeti midis viteve 1441-1460 u dha fund principatave vasale, duke i kthyer ato në pjesë të përhershme të Perandorisë. Për pasojë kjo do të ketë përmbyesjen e një sistemi dhe vendosjen e një tjetri, prej nga do të ngrihen strukturat që ishin në përputhje me konceptin e njohur shtetëror osman. Në këto rrethana, feudet e deriatëhershme vasale, u futën nën mbikëqyrjen shtetërore duke u konvertuar në *timare* ose u shpërndanë në *jaja*, si kompensim për shërbimin ushtarak, pra u bënë bujq turq që shërbenin me armatën. Kështu regjimi osman kishte vendosur një administratë të centralizuar në vend të decentralizimit feudal, siç ishte forcuar gjatë fazës së fundit të Bizantit, dhe kishte bërë rregullore të përgjithshme në vend të taksave dhe privilegjeve që kishin qenë në liri veprimi të mbikëqyrësve të feudeve.<sup>681</sup>

Në këtë sistem, *timari* paraqiste faktorin bazë mbi të cilin mbështeteshin të ardhurat, por edhe mbrojtja. Përcaktimi i tij si pronë që posedohej nga shteti për titullar kishte *spahiun*, i cili ishte përgjegjës për të por edhe për mirëvajtjen e prodhimeve bujqësore. Andaj, Perandoria nxitonte që sapo të vendoste pushtetin në viset e pushtuara, krahas ndarjes administrative, të bënte regjistrimin e pronave e të banorëve të saj në mënyrë që asgjë të mos i shpëtonte sistemit të ri. Me këtë rast shteti i besonte spahiut edhe autorizime të tjera, duke e bërë përgjegjës për rendin në katund.

Sistemi *timar* kishte për qëllim që të siguroheshin trupat për armatën e sulltanit, duke e mbajtur një forcë kalorësiake të madhe e të kontrolluar nga qendra. Kur sulltani urdhëronte fushatë lufte, spahinjë, nën komandën e subashit, i bashkonin radhët pas flamurit të sanxhakbeut. Sanxhakbejtë mbledheshin nën flamurin e bejlerbeut, kurse secili bejlerbej pastaj i bashkohej armatës së sulltanit në kohën dhe vendin që urdhërohej.<sup>682</sup>

Pra, *sistemi timar*, si një organizatë administrative, nga bejlerbeu deri te spahiu, *paraqiste pushtet ekzekutiv të sulltanatit në provinca*. Ata formonin njëfarë force policore, të ngarkuar me mbrojtjen e rajës në vend dhe njëkohësisht kishte detyra të rëndësishme për mbledhjen e taksave, si dhe për zbatimin e ligje-

---

<sup>681</sup> Shih: Babinger, F: "*Mehmet der Eroberer und sein Zeit*", München, 1953.

<sup>682</sup> Inxhalxhik, Halil: "*Perandoria Osmane*", I, Shkup, 2010, faqe 217.

ve të tokës. Në krye të administratës policore qëndronte *bejlerbeui* cili e përfaqësonte pushtetin e sulltanit në provincë.<sup>683</sup>

Nën *bejlerbeun* punonte *defterdari* dhe *defter kethydasi*, i cili rregullonte çështjet lidhur me timaret, kurse *hazine defterdari* i rregullonte çështjet e burimeve të të ardhurave që i takonin arkës qendrore të shtetit.

Nga fillimi *sanxhaku* ishte njësia kryesore administrative e Perandorisë. *Disa sanxhaqe e përbënin bejlerbejllëkun ose elajetin*, një nga të cilët njihej si “sanxhak i pashës” dhe ishte nën administrimin e drejtpërdrejtë të bejlerbeut. Disa njësi më të vogla, të njohura si *subashilik*, e përbënin sanxhakun, ndërsa vetë subashët jetonin në qytet dhe komandonin spahinj të jetonin në fshatrat e rrethit të tyre.<sup>684</sup>

Prona *has* e bejlerbeut ishte e shpërndarë nëpër sanxhaqe, ndërsa ato të sanxhakbeut nëpër subashllëqe.

Një ndarje tjetër e provincave ishte sipas *kadilik-ut*, regjion administrativ dhe juridik i kadiut. Vetë kadiu jetonte në qytet. *Kadiu përbënte boshtin e administratës osmane*, kurse në shekullin XV kadiu mund të ngrihej e të bëhej sanxhakbej ose bejlerbej.<sup>685</sup>

Shtylla e tretë e administratës provinciale ishte *hazine defterdari*, i cili pikërisht si personi përkatës në qeverinë qendrore, e përfaqësonte interesin e arkës shtetërore. Kështu, centralizimi i qeverisjes ishte qëllim që pashallarët në provinca të pengoheshin të mos bëheshin të plotfuqishëm. Këtij qëllimi i shërbenin edhe garnizonet e *jeniçerëve*<sup>686</sup> të vendosura në qytete, të cilat ishin një forcë tjetër për t’i penguar autoritetet vendore që të mos zbatonin fuqi arbitrare.<sup>687</sup>

---

<sup>683</sup> Po aty, faqe 223.

<sup>684</sup> Po aty, faqe 224.

<sup>685</sup> Po aty, faqe 225.

<sup>686</sup> Rendi i jeniçerëve paraqet kontingjentin e trupave elite perandorake, të themeluara në shekullin XIV, në kohën e depërtimeve osmane në Ilirik dhe Perëndim. Në këtë rend hynin rëndom fëmijët e të krishterëve që i nënshtroheshin *dëvshirmës*, ose taksës së gjakut, që jepej për Sulltanin. Fëmijët që merreshin në këtë urdhër dërgoheshin në Stamboll dhe ushtroheshin me një përkushtim të madh për t’u bërë luftëtarë. Krahas shkathësisive ushtarake, ata i nënshtroheshin edukimit shpirtëror që bëhej nën mbikëqyrjen e rendit bektashi. Jeniçerët nuk kishin të drejtë për familje. Me rendin e jeniçerëve lidhen thajse që të gjitha sukseset ushtarake të Perandorisë Osmane. Në shekullin XVII, u mor vendimi që trupat jeniçere të shpërbëheshin në dobi të një ushtrie profesionale. Sulltan Selimi III mori këtë vendim, ndërsa rendin e shpërbëri dhunshëm Sulltan Mahmuti II në vitin 1836, kur masakroi disa mijëra dervishë dhe jeniçerë fanatikë, të cilët ngritën krye kundër Sulltanit. Nga ajo kohë u ndalua edhe rendi i bektashinjve si dhe u rrënuan që të gjitha teqetë e tyre në Stamboll dhe rrethinë. Një pjesë e bektashinjve, megjithatë, strehë të sigurt gjeti në viset shqiptare dhe në Bosnje, ku vazhduan veprimtarinë e tyre të njohur. Gjatë Rilindjes Kombëtare komuniteti bektashi u vu në anën e lëvizjes kombëtare dhe disa prej tyre madje ishin edhe militantë të shqiptarizms. (Më gjerësisht shih Palmer, J. A. B “*The Origins of Janissaries*” (*Bulletin of the John Rylands Library*”, vëll.XXXV/1953).

<sup>687</sup> Inalxhik, Halil: “*Perandoria osmane*”, Shkup - Prishtinë - Tiranë, 2007, faqe 226.

Forcat *jeniçere* kishin nga treqind deri në pesëqind veta dhe vepronin vetëm nën urdhrin e sulltanit. Kjo formë e administrimit osman u vendos edhe në Arbëri, ndonëse si u tha më parë, kaloi nëpër dy faza të shtrirjes: në atë të parën që ka të bëjë me pushtimet e Mehmetit I nga viti 1431-1455, kur ai duke depërtuar nga pjesa e Plllovdivit drejt Perëndimit mori një nga një despotatet vasale, për të përfunduar me marrjen e Novobërdës, që gjendej nën zotërimet e vasalit të sulltanit, despotit *Vlk*, të cilin historiografia serbe, në përpjekjet e saj të pareshtura të konvertimit të Tribalëve dhe të Arbërve në serbë, e quan Branković<sup>688</sup> dhe të dytën, nga vitet 1479-1485 kur i gjithë vendi do të bjerë nën sundimin pesëshekullor osman.

Duhet thënë se pushtimet e fazës së parë dhe të dytës, përfundojnë me përfshirjen e vendeve të Arbrit nën *elajetin* Rumelisë, emërtim ky që vinte nga fjala *rum*, që do të thotë i krishterë, ndërsa *Rumeli* vend i të krishterëve. Meqë edhe Arbrit, si edhe popujt tjerë të kësaj pjese ishin të krishterë, ishte fare e natyrshme që edhe ata të përfshiheshin në këtë pjesë administrative, ku mbetën gjatë gjithë kohës së sundimit osman.

Kur jemi te përcaktimi i *elajetit*, si njësi e madhe administrative, që përbëhej nga sanxhaqet, megjithatë, duhet përmendur edhe *vilajetin*, si njësi e cila gjendej brenda sanxhaqeve, por që ka një kuptim sa më të veçantë, ngaqë Osmanët, tokat posa të pushtuara nga të krishterët i quanin *vilajete - provinca* dhe ato kishin status të posaçëm. Ato, zakonisht drejtoheshin nga vendësit.<sup>689</sup>

Pra, *vilajet* mund të *quhej administratë e vendit*, meqë feja myslimane ende nuk ishte përhapur në viset evropiane në masë të konsiderueshme. *Vilajeti* mund të kishte madhësi të ndryshme. Vetëm nga gjysma e dytë e shekullit XIX *vilajet* do të thotë njësi më e madhe administrative e Perandorisë Osmane.<sup>690</sup>

Vendosja e pushtetit osman, si edhe në pjesët e tjera, përcillej me regjistrat kadastralë të sanxhaqeve (*Defter-i Sancak*), të cilët bënë pjesë në *elajete*, ku edhe lidhej administrimi i aparatit shtetëror perandorak. Dokumenti më i hershëm i zbuluar deri më tani i kësaj natyre është një regjistër kadastrë i vitit 835 h (1431-1432), i emërtuar "*Regjistri i sanxhakut të Arbrit*" (*Defter-i Sancak-i Arvanid*). Në të janë përfshirë një pjesë e viseve perëndimore, që shtriheshin nga Çamëria deri te lumi Mat. Krahas pasqyrimin të shpërndarjes së timareve në çastin e hartimit të regjistrin,

<sup>688</sup> Nikolić, Maja: "The Byzantine Writers on Serbia 1402-1439", Beograd, 2010, faqe 41.

<sup>689</sup> Rizaj, Skënder: "Kosova gjatë shekujve XV, XI dhe XVII", Prishtinë, 1982, faqe 50.

<sup>690</sup> Po aty, faqe 50.

në të ka edhe shënime që u referohen periudhave më të hershme, kohës së Sulltan Bajazitit I (1389-1402) dhe Sulltan Mehmetit I (1413-1421).<sup>691</sup>

Një defter tjetër, ndër të parët, që ka të bëjë me viset e Dardanisë, është ai i *Vilyet-i Vlk* (nga historiografia serbe i quajtur “Oblast Brankoviqa”)<sup>692</sup>, i bërë në vitin 1455, pas pushtimit të Dardanisë nga Osmanët, me anën e fushatës, që e drejtoi personalisht Sulltan Mehmeti.

Sipas *Defter-i Mufassal, Vilayet-i Vlk*, ky vilajet i madh ndahej në 7 *nahije*: Trgovishtë (Rozhajë), Kllopatnik (Drenicë), Dollc, Moravë (Gjilan), Vuçitërna, Topollnica, Prishtina dhe Llabi. Kah jugu vilajeti shtrihej deri te Shkupi. Kah lindja shtrihej deri te Lebani. Kah veri-lindja deri te Bllaca dhe Prokupja. Kah veriu deri në Priboj. Ndërsa kah veri-Perëndimi deri te Rozhaja.<sup>693</sup>

Pak më vonë nga ky vilajet u formua Sanxhaku i Vuçitërnës, i cili sipas defterëve të vitit 1477/78 tregon gjendjen e timareve në subashllëqet e Vuçitërnës, Llabit, Obrovcit të Epërm, Prishtinës, Moravës dhe Toplicës. Pak më vonë, ky sanxhak do të zgjerohet edhe me pjesë të tjera. Kështu sipas defterëve të vitit 1521-1522 në këtë sanxhak përfshiheshin pjesët deri në Kopaonik me pjesën e Gollakut, kurse në jug shkonte deri te Mali i Zi i Shkupit, duke përfshirë këto qendra: Prishtinën, Vuçitërnën, Trepçën dhe Novobërdën.<sup>694</sup>

Nga defterët e vitit 1530/3, Sanxhaku i Vuçitërnës ndahej në këto kaza: Novobërdë, Prishtinë, Bellasicë, dhe Vuçitërnë. Kishte 9 *kasaba* (Vuçitërnën, Prishtinën, Janjevën, Novobërdën, Bellasicën, Trepçën, Trepçën e Poshtme, Bellobërdën dhe Koporiqin), kishte 1084 katunde, 68 mera, qifllëqe, 4 xhami, 10 mesxhide, 42 manastire, 11 kisha, 4 hamame dhe 2 karvasaraje. Në tërë sanxhakun kishte 26.573 banorë, një sanxhakbe 4 kadi, 5 zaim, 293 spahi, 1 dizdar, 48 mbrojtës të fortifikuar, 13.780 shtëpi *avarize*, që paguanin taksën *avariz*. Sanxhaku kishte vetëm 283 myslimanë.<sup>695</sup>

Sanxhaku i Vuçitërnës do të jetë i rëndësishëm gjatë gjithë kohës dhe, ai në një farë mënyre, do të kthehet në barometër të zhvillimeve shoqërore, ekonomike dhe atyre shpirtërore, që do të nxjerrë karakterin etnik të autoktonisë së Arbërve

---

<sup>691</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i parë, Tiranë, 2002, faqe 378.

<sup>692</sup> Shih: Hadžibegović-Handžić-Kovačević: “*Oblast Brankovića*”, Sarajevë, 1972;

<sup>693</sup> Më gjerësisht rreth konvertimit të “*Vilajetit Vlk*”, siç shfaqet në dokumentet osmane, në “*Oblast Brankovića*”, sipas spekulimeve të historiografisë serbe shih: Hadžibegović-Handžić-Kovačević: “*Oblast Brankovića*”, Sarajevë, 1972; Radonjić “*Đorđe Branković i njegovo vreme*”, Beograd 1911.

<sup>694</sup> Po aty.

<sup>695</sup> Rizaj, Skënder: “*Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*”, Prishtinë, 1982, faqe 53.

dhe më vonë të Shqiptarëve që në shekujt XVII dhe XIX pasqyrohet me një shtrirje të natyrshme deri te Sanxhaku i Nishit.

Sanxhaku i Prizrenit, ai i Shkodrës dhe i Dukagjinit, pasqyrojnë ndryshimet nëpër të cilat kalojnë këto pjesë nga vasalitetet deri te pushtimet e plota, që ishin karakteristike për rrethanat midis viteve 1420-1479, kur rikthente rëndësinë që kishin këto pjesë për ndërtimin e asaj që do të shfaqet si tërësi etnike me veçoritë e veta, siç ishin vetëqeverisjet dhe statuset e veçanta që do të kenë këto pjesë edhe gjatë pushtimit osman.

Kështu, mund të thuhet se nga viti 1455 kur Dardania dhe Veriu i Arbërisë ranë në pushtimin osman, këto pjesë, krahas sanxhaqeve të Vuçitërnës dhe Shkupit administroheshin edhe nga sanxhaqet e Prizrenit, të Shkodrës dhe Dukagjinit, që i takonin Ejaletit të Rumelisë.

*Sanxhaku i Vuçitërnës* ishte sanxhaku i parë i Dardanisë mesjetare. Ky sanxhak i formua pas vitit 1455, pas shuarjes së “*Vilajetit Vlç*”, përfshiu një pjesë të mirë të hapësirës së Dardanisë, pra viset nga Kopaoniku në veri e deri te Karadaku i Shkupit në jug, nga Toplica e Llapi dhe Gollaku në lindje, e deri te Famullia e Sienicës, Sharrit dhe Drenicës në perëndim, të cilat ndërlidhin natyrshëm hapësirën etnike arbërore. Sanxhaku i Vuçitërnës mbeti i tillë deri në vitin 1689, kur hyri nën juridiksionin e Sanxhakat të Shkupit.<sup>696</sup>

Sanxhaku i Prizrenit, i formuar pas vitit 1459, përfshinte një territor shumë të gjerë, nga Sharrin në jug, e deri te Jeni Pazari, Bihori dhe Bërveniku në veri, nga Drenica në lindje e deri te rrethi i Pejës dhe i Gjakovës në perëndim. Edhe ky sanxhak, në rrethanat e reja, ua rikthente rëndësinë rrugëve që Dardaninë e lidhnin në një rën anë me pjesët perëndimore, por edhe me ato lindore.

Nga ana tjetër, Sanxhaku i Dukagjinit, historia e të cilit daton nga viti 1462, me qendër në Pejë dhe në Lezhë, përfshinte territorin, nahijen (vilajetin) e Malit të Zi, pastaj nahijen - kazanë e Pejës dhe të *Alltun-Ilisë* (pjesët nga Gjakova deri në Tropojë) në veri, dhe deri në Dibër e Mat në jug, nga Luma dhe Opoja në lindje, e deri te Lezha (Adriatiku) në perëndim.<sup>697</sup>

Sanxhaku i Shkodrës formohet pas pushtimit të këtij qyteti nga Osmanët në vitin 1479. Atij do t'i bashkohen edhe disa krahina të sanxhakat të Dukagjinit. Sipas defterit të vitit 1485, sanxhaku i Shkodrës ishte ndarë në 4 kaza: të Shkod-

---

<sup>696</sup> Po aty, faqe 65.

<sup>697</sup> Po aty, faqe 65.

rës, të Podgoricës, të Pejës dhe Bihorit. Kazaja e Pejës ndahej në nahije të Pejës dhe të Alltunllisë (pjesë midis Gjakovës – Junikut – Tropojës).<sup>698</sup>

Nahija e Pejës, kah fundi i vitit 1578, gjendet në përbërje të Sanxhakut të Dukagjinit. Mali i Zi, pak më herët (1576) i kthehet përsëri Sanxhakut të Shkodrës.<sup>699</sup>

Pasqyra e sanxhaqeve, me gjithë ndryshimet e shumta, siç ishin ato kur pjesë të tyre kalonin nga njëra në tjetrën, mund të kuptohet vetëm po qe se përcillet me raportet e njëmendta të pronës, që solli shteti osman në këto anë, mbi të cilat pastaj do të mbështetet i gjithë zhvillimi shoqëror, ekonomik dhe politik. Natyrisht se pikënisje e këtij ndryshimi paraqiste sistemi *timar*, i cili mund të cilësohet se ishte njëfarë feudalizmi shtetëror, që si rend i tillë shoqëror paraqiste një hap përpara në krahasim me atë evropian, i cili ishte në shthurje e sipër. Mirëpo, qysh në gjysmën e dytë të shek. XVI, ky sistem filloi të shthuret, e në gjirin e tij filluan të lindin elementet e parë të sistemit çifligar, rend ky, i cili, me tiparet e veta, i përgjigjej një lloj feudalizmi specifik.<sup>700</sup>

Megjithatë, derisa u arrit sistemi çifligar, të cilit do t'i duhen më shumë se një shekull e gjysmë kohë, statusi i pronës së pushtuar në Rumeli kishte tretmanin e *mirisë* (*eraz-i miriye, ose eraz-i memleket = tokë e shtetit*), që do të thotë se ato nuk u janë ndarë pushtuesve, por janë dhënë në shfrytëzim. Kështu, pronat e patundshme që u janë dhënë në shfrytëzim autoriteteve osmane, që ata të kryenin shërbime ushtarake, quheshin *dirliqe*, dhe ishin të kategorizuara në tri kategori: *has*, *ziamet* ose *ziamet* dhe *timar*. *Dirliku*, ishte pronë për ekzistencë, për mbajtjen e ushtrisë, njëfarë rroge, që nuk mund të trashëgohej e as të shitej. *Hasi* ishte *derliku* më i madh. Prej tij fitoheshin të ardhurat vjetore prej 100 mijë akçe. Nga defterët e vitit 1256-28 shihet se *has i sulltanit* ishin Prishtina, Trepça dhe Novobërda. *Hase të sulltanit* u shpallën të gjitha xeherorët Novobërda, Trepça, Janjeve e të tjera.<sup>701</sup>

*Has i sulltanit* ishte edhe Gjakova me të ardhura prej 3 mijë akçe si dhe pjesët e tjera përreth. *Zeameti* ose *ziamet* ishte *dirlik* i kategorisë së dytë sipas madhësisë, me të ardhura vjetore prej 20 mijë deri në 99 mijë akçe. U jepej allaj-bejlerëve, komandantëve të flotave dhe mbajtësve të defterëve të *timareve*. Shfrytëzimi i *ziametit* quhej *zaim*. *Timari* ishte *dirlik* i kategorisë së tretë, me të ardhura

<sup>698</sup> "Defteri i regjistrit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485", I, II, Tiranë, 1974, i përgatitur nga Selami Pulaha, faqe 5.

<sup>699</sup> Rizaj, Skënder: "Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII", Prishtinë, 1982, faqe 63.

<sup>700</sup> Po aty, faqe 78.

<sup>701</sup> Rizaj, Skënder: "Rudarstvo Kosova i susednih krajeva od XV do XVII veka", Prishtinë, 1968, faqe 3-22.



ra vjetore prej 3 mijë deri në 19. 999 akçe. Në trevat e sanxhaqeve ku ishin të përfshira një pjesë e viseve të Dardanisë, ekzistonin gjithsej 939 timare, prej tyre 344 ishin në sanxhakun e Shkupit, 53 në sanxhakun e Dukagjinit, 225 në sanxhakun e Prizrenit dhe 317 në sanxhakun e Vuçitërnës.<sup>702</sup>

Përpos *derlikut* kishte edhe kategori të tjera toke: *vakëf*, *oxhallëk* dhe *mukata*. Ishin këto toka që shteti ua ndante institucioneve të dobishme: *xhamive*, *medreseve*, *spitaleve* dhe *internateve*. Ndër këto kategori toke, gjithsesi se *oxhallëku* ishte me interes për ndërtimin e strukturave drejtuese dhe atyre shoqërore në viset e pushtuara, të cilat ngriheshin në përputhje me konceptet perandorake. Kështu, krahas komandantëve të fortifikatave, që quheshin *dizdarë*, këto prona u jepeshin në shfrytëzim edhe feudalëve vendorë, që përqaфонin islamin dhe në këtë mënyrë fitonin të drejtën që të përfshiheshin në radhën e titullarëve të lartë të administratës ushtarake të Perandorisë Osmane, siç ishin Rrotullajt, Mahmut-begollët dhe Bushatlinjtë, të cilët udhëhiqnin Sanxhakun e Prizrenit, të Dukagjinit dhe të Shkodrës.<sup>703</sup>

Krahas pronave të shtetit, të cilat nuk ishin trashëguese, shfaqeshin edhe të ashtuquajturat *bashtina*, të cilat ishin trashëguese. Fjala është për prona, siç ishin vreshtat, kopshtet dhe shtëpitë, të cilat u takonin të krishterëve. *Bashtina* ishte tokë që trashëgohej nga babai.

Zbatimi i sistemit timar në tokat e pushtuara, veçanërisht në ato të Arbrit, me të cilin në njëfarë mënyre u rikthye *pronia* bizantine e fazave të hershme, preku shtresat e ndryshme shoqërore po ashtu në mënyra të ndryshme, me ç'rast mund të thuhet se ajo bujkun e rëndomtë e ktheu pranë pronës, të cilën ai e punonte dhe me këtë plotësonte arkën e shtetit dhe të strukturave që u rrinin sipër (spahinjve dhe të tjerëve nga zinxhiri shtetëror), por në të njëjtën kohë *rrënoi fisnikërinë dhe bujarinë vendore*, e cila përgjithësisht u zhvesh nga pronat e veta. Vetëm një pjesë e tyre u integrua në radhët e spahinjve e të drejtuesve të shtetit osman.

Mirëpo, vendosja e sistemit të timareve me spahinj të si bartës kryesorë të tij nuk eliminoi në tërësi nga skena shoqërore dhe politike shtresën e deriatëhershme të fisnikëve vendorë si dhe rolin e tyre. Sistemi timar ndryshoi rrënjësisht konceptin e pronës dhe të shfrytëzimit të saj duke e kthyer atë në pronë të shtetit të mbikëqyrur rreptësisht nga sistemi i krijuar, por ajo nuk përjashtoi faktorët vendorë që të përfshihen në atë sistem. Madje, shumë të dhëna, por edhe veprimet,

<sup>702</sup> Rizaj, Skënder: "Kosova gjatë shekujve XV, VI dhe XVII", Prishtinë, 1982, faqe 78.

<sup>703</sup> Po aty, faqe 79.

bëjnë të ditur se Osmanët kishin një qasje shumë parimore ndaj fisnikërisë arbërore në mënyrë që ajo të bëhej pjesë e sistemit të vendosur prej tyre. Kështu, qysh në fillim një pjesë e tyre u përfshinë në sistemin e spahinjve, pa u bërë kushtëzime fetare. Por, edhe pa ndodhur kjo kthesë, gjatë kohës së vasaliteteve, që mund të vlerësohet si një parapërgatitje për sistemin e ardhshëm pushtues, Osmanët i detyruan fisnikët arbërorë, pa përjashtuar këtu edhe mënyrat e stimulimit, që t'i dërgonin fëmijët e tyre si pengje në oborrin e sulltanit, si *il-ogllanë* (*pazhë*), shkollim i elitës, ku pasi që konvertoheshin në fenë islame, ata edukoheshin me frymën e besnikërisë ndaj sulltanit. Pas një dekade, kur mendohej se ishin formuar Osmanlinj të vërtetë, sipas aftësisë që tregonin, ata pajiseshin me timare të mëdha dhe ofiqe të larta. Nëpër institucionin e *iç-ollganit* kaluan i biri i Gjon Kastriotit, Skënderbeu, i biri i Teodor Muzakës, Jakup Beu, i biri i Gjon Zenebishit, Hamza Beu e shumë e shumë të tjerë, që do të bëjnë emra në hierarkinë e lartë perandorake.<sup>704</sup>

Një masë tjetër, që stimuloi kapërcimin por edhe integrimin e një pjese të fisnikërisë arbërore në sistemin administrativ dhe ushtarak osman ishte ajo e *gulam-it* (djalit të rritur). Kjo kishte të bënte me qëndrimin e një pjesë të të bijve të fisnikëve vendorë pranë bejlerbejve dhe sanxhakbejve, të cilët shërbenin pranë tyre që të përgatiteshin për karrierën e feudalit osman. Pas kësaj, *gulamëve* të islamizuar mund t'u jepeshin si timare edhe pronat e familjes ose të afërmeve të tyre. Kështu, *iç-ollganë e gullmë* me origjinë arbërore morën timare dhe poste jo vetëm në vendin e tyre, por edhe në pjesë të tjera të Perandorisë Osmane.<sup>705</sup>

Edhe përkundër këtyre zhvillimeve, zbatimi i sistemit timar në Arbëri, jo vetëm nuk shkoi siç pritej - edhe pse në njëfarë mënyre shpronësimi i njëjës anë (feudalëve) u përcoll edhe me "pronësimin" (pajisjen) e bujqve me tokë pune, që ishte edhe një zhvillim pozitiv - por u përcoll edhe me vështirësi dhe madje kundërshtime të shumta, që çuan edhe deri te kryengritje të ndryshme.

Natyrisht se ky kundërshtim ishte edhe i pritshëm, meqë i gjithë procesi u përcoll me masa të dhunshme, siç ishte regjistrimi i popullatës dhe pronës (*mufasal*) - ku kishte shumë e shumë parregullsi dhe veprime arbitrare të spahinjve për të vënë nën mbikëqyrje pjesë sa më të mëdha të tokave, pa ua vënë veshin raporteve vendore dhe veçorive - në mënyrë që pastaj çështja të ndizej edhe me veprimet e feudalëve vendorë kundër këtij zhvillimi, të cilët aty për aty shpronë-

---

<sup>704</sup> "Historia e Popullit Shqiptar", vëllimi i parë, Tiranë, 2002, faqe 328.

<sup>705</sup> Po aty, faqe 382.

soheshin pa ndonjë zhdëmtim. Mundësia që u ofrohej që të pranonin sistemin e spahinjve dhe të hynin në të, për shumë sish ishte e papranueshme për shkak të kushtëzimeve, siç ishte pranimi i islamit, ndonëse kjo nuk thuhej haptas dhe nuk ishte e thënë që gjithnjë të ndodhte, meqë do të ketë edhe spahinj të krishterë siç do të ketë edhe titullarë të lartë, por që nënkuptohej në ato rrethana.

Në këto rrethana, kur sanxhakbejtë jo rrallë përdornin edhe forcat ushtarake për të zbatuar sistemin e timarit (sulmoheshin fshatrat e pabindura), duke i shndërruar në gërmadha, shënoheshin revolta dhe kryengritje të armatosura. Në shënjestër të këtyre revoltave u vunë spahinj të dhunshëm, rëndom nga shtresa e ardhur ushtarake, të cilët ktheheshin në caqe të shpeshta. Nga një regjistër i vitit 1431-1432, në vilajetin e Pavël Kurtit, të Çartallozit të Tomoricës, të Këlcyrës e të tjerë, asnjë timar nuk ishte më në zotërimin e spahinjve me prejardhje të huaj, që kishin qenë gjatë regjistrimit të mëparshëm.<sup>706</sup>

Kryengritjet e fisnikëve të Arbrit kundër vendosjes së pushtetit osman në trojet e tyre, në vitet e njëzeta dhe të tridhjeta të shekullit pesëmbëdhjetë, për t'u ndërlidhur pastaj me ato deri në të tetëdhjetat, kanë të bëjë me dy faktorë të kohës. I pari kishte të bënte me zgjerimin e pashasanxhakut të Shkupit nën familjen e Evrenozëve, e cila ishte fuqizuar ekonomikisht dhe kjo shkonte në dëm të feudalëve arbërorë që rrenoheshin përpara fushatës së tij, e cila bëhej gjithnjë e më e madhe në të gjitha drejtimet. Ndërsa faktori i dytë lidhej me luftën osmane-venedikase për Selanikun (1428-1430), nga e cila kërkoheshin përfitime, veçmas pse mendohej se kjo do të çonte pozitën e Osmanëve, që duhej shfrytëzuar.

Si do të shihet, nga ky hesap, arbitri do të kenë vetëm dëme dhe aspak dobi, sepse ndalimi i forcimit të Evrenozëve ishte i pamundur (këtë do ta kuptojë më së miri Gjon Kastrioti kur ai do të sulmohet prej tij bashkë me forcat e Gjergj Brankoviçit dhe do t'i rrezikohen seriozisht zotimet që kishte për rikthimin e të cilave do të duhet edhe ndërhyrja e të bijve, Skënderbeut dhe Stanishës pranë autoriteteve osmane, që do të përfundojë me një marrëveshje të tij me Isak Beun). Ndërkohë edhe hesapet nga lufta osmane-venedikase për Selanikun, dolën njësoj të gabuara meqë Osmanët, pas nënshkrimit të paqes me Venedikun, përjashtuan fisnikët dhe princat vasalë të Arbrit nga çfarëdo lidhjeje ose marrëveshjeje me perëndimorët, duke marrë përsipër vetë këtë çështje. Edhe këtu, familja e Gjon Kastriotit do të ndjehet më e dëmtuara, meqë ajo edhe pasi pranoi vasalitetin (supo-

---

<sup>706</sup> Po aty, faqe 385.

zohet viti 1410) mbajti lidhje paralele me Venedikun me anën e disa marrëveshje, (ato për garancitë që u jepeshin venedikasve për shfrytëzimin e rrugëve Lezhë-Prizren dhe çështjeve të tjera), që kishin të bënin me interesat e vendit.<sup>707</sup>

Përkundër marrëveshjes së Gjon Kastriotit me Evrenozët, që solli deri te njëfarë rimëkëmbje e principatës së Kastriotit, megjithatë, sulltani i trimëruar nga marrëveshja me Venedikun që ia siguroi Selanikun, si një pikë të rëndësishme që lidhte pjesën lindore me ato rishtas të pushtuara në hapësirën europiane, përqendroi forcat e tij në viset arbërore me qëllim që të shkojë më tutje në drejtim të Perëndimit, për t'u dhënë fund hesapeve me Hungarinë. Kështu, bëhet e ditur se në dimrin e vitit 1432-1433 sulltani u vendos në Serez. Çak i tij ishte Gjergj Arianiti, i cili kishte filluar të sulmonte spahinjtë osmanë që ishin vendosur në pjesët e atjeshme pasi që të ishte liruar fshehtas nga oborri i sulltanit ku mbahej peng prej nga ishte kthyer në atdhe dhe kishte filluar një kryengritje e cila nga dita në ditë po merrte përmasa gjithnjë e më të mëdha dhe kërcënonte që të rrëronte të arriturat në vendosjen e sistemit timar në shumë pjesë.<sup>708</sup>

Para se të qëronte hesapet me Arianitët, Sulltani duhej të thyente rezistencën që kishte filluar Andrea Thopia, i cili pas regjistrimit mufasal u zhvesh plotësisht nga zotërimet që kishte në trevën e Durrësit, Petrelës dhe Krujës, në mënyrë që t'i jepte fund gjendjes së vasalitetit e cila duhej të përcillej me vendosjen e plotë të pushtetit osman në këto anë. Edhe pse nuk dihej me saktësi kahu i kësaj fushte ndaj Thopisë, megjithatë, ai humbi një pjesë të mirë të zotërimeve, sidomos kalatë (Krujën, Petrelën dhe Danjën) por rezistencën e tij në disa pjesë e vazhdoi edhe më këndeje dhe u shtri edhe në afërsi të Lezhës.<sup>709</sup>

Megjithatë, kryengritja e Thopisë nuk kishte gjasa për ta përfshirë Lezhën ose pjesët e tjera veriore, meqë aty ishte Venediku, i cili pasi kishte humbur Selanikun, nga një marrëveshje e lidhur me sulltanin, ruante Durrësin, Lezhën, Shkodrën dhe disa pjesë të tjera në bregdet, nuk lejoi që fisnikët dhe princat e shpronësuar arbërorë t'ia prishin hesapet me Osmanët. Kjo madje, nuk iu lejua as Nikollë Dukagjinit, i cili pasi që kishte kaluar në pjesën që e mbikëqyrnin venedikasit, kërkoi të rikthente Danjën. Venedikasit e penguan atë në këtë veprim dhe njëherësh nxituan që atë ta marrin dhe t'ua rikthejnë Osmanëve. Nga një letër që

---

<sup>707</sup> Rreth lidhjeve të Kastriotëve me Venedikun shih: Schmitt, Olivier Jens: "Das venezianische Albanien 1892-1479", München 2001 dhe "Arbëria venedike", Tiranë; Frashëri, Kristo: "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", Tiranë; Plasari, Auerele "Skënderbeu", Tiranë.

<sup>708</sup> Bozhari, K: "Lufta shqiptaro-turke e shekullit XV. Burime bizantine", Tiranë, 1967, faqe 44-46.

<sup>709</sup> Buda, Biçoku, Bozhari, Pulaha: "Dokumente rreth kryengritjeve shqiptare kundër pushtuesit osman në vitet 30 të shek. XV" në "Studime historike", nr. 1. 1967, faqe 147-162, dok, nr, Venedik, 19 shkurt 1432.

Senati ia dërgonte Sulltanit i bëhej e ditur se Republika respektonte paqen me Sulltanin, që e quante “vëlla”, dhe se për këtë arsye Kontit të Shkodrës i ishte urdhëruar që të mos u jepte as Nikollë Dukagjinit, as krerëve të tjerë kryengritës strehim e as përkrahje, as të holla, as prona.<sup>710</sup>

Në këto rrethana, pra kur Venediku - shpresa kryesore e Arbërve, tashmë kishte lidhur paqe me Osmanët, ndërkohë që Kastriotët po ashtu ishin përfshirë në një marrëveshje të dyanshme (me Osmanët dhe Venedikasit) për përmbajtje, Thopisë dhe Dukagjinëve, nuk u mbetej tjetër pos ndonjë shpresë, që kryengritjet të shfaqeshin në zotërimet e tjera jashtë atyre të fqinjësisë me ato të Venedikut. Kjo gjithsesi do t’u vijë nga Gjergj Arianiti (Arianit Komnini), i cili sapo të jetë liruar nga pengu i Sulltanit në Edrene, u kthye në zotërimet e tij dhe ndezi kryengritjen, që u shpall me vrasjen e spahinjve që ishin vendosur aty si timarlinj dhe drejtonin pronat e tij.<sup>711</sup>

Pas sukseseve të para, kryengritja u shtri në jugperëndim të vendit, me synimin që të merrej Gjirokastra, kryeqendra e *Sanxhakut Arvanid*.<sup>712</sup> Bëhet e ditur se Sulltani, që ndodhej në Serez, detyrën për ta hequr qafesh Arianitin dhe kryengritjen e tij ia besoi komandantit të Shkupit Ali bej Evrenozit, i cili depërtoi nga ajo pjesë dhe kryqëzimin e parë dhe më të rëndësishmin me Arianitin e pati në luginën e Shkumbinit, me ç’rast forcave të tij iu shkaktuan humbje të rënda nga ato të Arbërve, të cilat ishin të lëvizshme dhe në gjendje që t’i iknin luftës ballaballas. Evrenozit, i cili ishte i ngarkuar nga Sulltani që t’ia sillte rob djalë dhe Komninit (Gjergj Arianiti) mezi ia doli që të kalojë në pjesën tjetër dhe t’i ribashkojë forcat e shpartalluara në Epir, por si humbës.<sup>713</sup>

Sipas kronistit bizantin, Halkokondili, sulltani e kishte pajisur Ali bej Evrenozin për të shtypur kryengritjen jo vetëm me ushtrinë e tij, por edhe me ato të Aksit (sanxhakut të Shkupit). Ai i kishte dhënë gjithashtu porosi që të shkatërronte me këtë ushtri vendet arbërore. Por, Arianiti kishte lënë ushtrinë turke të futej në viset malore, pa ndeshur në qëndresë, por në kthim e sipër, ua kishte zënë shtigjet dhe u solli një humbje të rëndë.<sup>714</sup>

---

<sup>710</sup> Po aty, dok. Nr. 9, Venedik.

<sup>711</sup> Bozhari, K: “*Lufta shqiptaro-turke e shek. XV. Burime bizantine*”, Tiranë, 1967, faqe 44-46.

<sup>712</sup> Frashëri, Kristo: “*Gjergj Kastrioti Skënderbeu*”, Tiranë 2002, faqe 109.

<sup>713</sup> Më gjerësisht rreth kryengritjes së Arianitëve si dhe rolit të tyre në këtë zhvillim shih nga Babinger, Franz “*Fundi i Arianitëve*”, Tiranë 2004; Hopf, Karl “*Chroniques greco-romanes inedites au peu connues*”, Berlin 1873; “*Despotes et dynastes d’Epire et de Thessalie*”; Jakova, G: “*Genealogi dei Prinvipi Albanesi*”, Frascati 1904; J.G von Hahn: “*Udhëtime në viset e Drinit e të Vardarit*”, 1865.

<sup>714</sup> Chalcocondylae, Leonici: “*Historiarum Demonstrationes*”, ed. E.Darko, Budapestini, 1922 dhe Frashëri, Kristo: “*Gjergj Kastrioti Skënderbeu - jeta dhe vepra*”, Tiranë 2002, faqe 111.

Krahas humbjes që pësoi Evrenozi, me Arianitin dhe princat dhe kapedanët e tjerë arbërorë që iu bashkuan kësaj kryengritje (Thopinë, princ i një pjese të Epirit Arnith Spatën), as Sulltani nuk do të ndahet më mirë. Në vitin kalendarik 1434 shënohet se Sulltan Murati hyri me një ushtri të madhe në Arbëri, por aty u thye përsëri dhe ndonëse nga të dyja anët pati dëme të mëdha në njerëz, vetë Andrea Thopia dhe Arnith Spata, gjeneral i ushtrive të Arbrit e drejtoi kaq mirë këtë luftë sa që Sulltani u detyrua të tërhiqej pa pasur ndonjë përfitim dhe në fund të po atij viti, po ata komandantë arbërorë i shkaktuan një disfatë po aq të thellë Isakut, gjeneralit të turqve, i cili i favorizuar nga ngricat kishte hyrë në atë krahi-në për ta shpopulluar.<sup>715</sup>

Sukseset e Gjergj Arianitit u përcollën me entuziazëm në Itali dhe Europë, ngaqë ishin të parat pas shumë e shumë humbjeve të të krishterëve nga Osmanët. Vetë Papa Eugjeni IV, në shtator të vitit 1434, lëshoi një enciklikë drejtuar të gjitha hallkave të hierakisë kishtare, që t'u falen mëkatet gjithë atyre që do të ndihmojnë luftën e shenjtë kundër armikut osman, ashtu siç po luftojnë “burrat fisnikë, princat, dukët, kontët, baronët dhe popullsitë nga kombi shqiptar”.<sup>716</sup>

Ato ngjallën shpresa se Osmanët do të mund të hiqnin dorë nga fushatat ushtarake për t'iu kthyer marrëveshjeve siç ishin ato të kohës së vasaliteteve, kur ata qeverisnin zotërimet e tyre në mënyrë autonome dhe për këtë paguanin haraç, ose që ato të anashkaloheshin për një kohë të pacaktuar, kjo nuk ndodhi, edhe pse mund të thuhet se gjatë atij dhjetëvjetëshi sa Osmanët ishin të drejtuar në fushatë kundër Hungarisë, sikur ra intensiteti ushtarak. Ishin dy faktorë që i ndihmuan kësaj: në njërën anë mos lëvizja e Gjon Kastriotit, Nikollë Dukagjinit, Andrea Thopisë dhe bujarëve të tjerë të vegjël, të cilët ishin pajtuar me gjendjen e re me kusht që të ruanin disa nga privilegjet, ndonëse nuk mund të ishin të sigurt, dhe në tjetrën anë, lojërat e njohura të Venedikut që të mos lejojë që veprimet e Arbërve t'ia rrezikojnë zotërimet e tij në vendet e Arbrit, që kishte siguruar pas paqes që kishte lidhur me Osmanët në vitin 1430.

Në këtë kohë, madje vërehet se sulltan Muarti II u përpoq të mbështetej te ata fisnikë vendas që ishin të lidhur me administratën vendore osmane. Krahas Evrenozëve, që vazhduan të mbeteshin në krye të pashanxhakut të Shkupit, gjatë viteve 1432-1438, Sulltani emëroi sanxhakbe të *Sanxhakut Arnavud-ili*(Sanxha-

---

<sup>715</sup> Shih: Rizaj, Skënder: “Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII”, Prishtinë, 1982, faqe 25; Frashëri, K: “Gjergj Kastrioti Skënderbeu - jeta dhe vepra”, Tiranë, 2002, faqe 109.

<sup>716</sup> BBBP, *Dokumenta*, nr.13, Firence, 9 shtator 1434., cit. F. Kristo: “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu”, Tiranë 2002, faqe 111.

kut Arbëror) të birin e Teodor Muzakës, Jakup Beun (1441), i cili ishte njëri ndër ushtarakët më të dalluar të Perandorisë Osmane. Ai u vra më 1442 në luftë kundër hungarezëve. I vëllai Kasim Pashai, me 1442 përmendet si beg i *Sanxhakut Arnavud-ili*, kurse i vëllai i Kasem Pashës, Sylejmani, më 1449, gjendet në postin e subashit të Beratit. Edhe Ballaban beu në verën e vitit 1434 ishte emëruar në postin e dizdarit të Krujës. Subash në Kalkandelen (Tetova e sotme), më 1445, gjendej edhe Hamza beu nga familja e Gjin Zenishtit. Gjithashtu edhe një komandant kufitar i sulltan Muratit II, Is-haku, ishte Arbëror.<sup>717</sup>

Kështu, Arbrit, bashkëthemelues të Bizantit, mbështetës kryesorë të tij, të cilët në dyqindvjetshin e fundit ishin gjendur në luftën e ashpër për përvetësim midis kryqit lindor dhe atij perëndimor, prej nga në forma të ndryshme, siç ishte “*Despotati i Arbrit*” ose “*Mbretëria e Arbërisë*”, kishin mundësi të përcaktoheshin për kurorën e tyre mbretërore, në këto rrethana, ishin në prag të shpërbërjes për ta humbur emrin dhe kujtesën historike. Rasti i marrëveshjes midis Osmanëve e Venedikasve pas luftës për Selanikun si dhe kryengritjet e Arianitëve kundër vendosjes së sistemit timar, treguan qartë se ishin kthyer në një monedhë për kusuritje.

Por, do të jetë shfaqja e Gjergj Kastriotit Skënderbeut, që do ta ndalë këtë zhvillim për t’i kthyer Arbrit në histori papritmas, por në mënyrën më madhështore njëherësh.

---

<sup>717</sup> Po aty, faqe 391.

## KAPITILLI I DYTË

### GJERGJ KASTRIOTI –SKËNDERBEU

#### KASTRIOTËT DHE ARBËRIA

Fundi i Arianitëve, me të cilin lidhet edhe vendosja e sistemit *timar* në Arbëri, edhe pse shënoi fundin e fisnikërisë arbërore, e ngritur në dy shekujt e fundit në rrethanat kur pushteti qendror i Bizantit ua kishte lëshuar vendin feudalëve të fuqishëm dhe qeverisjes së tyre autonome, ndonëse të shpronësuar, nuk i hoqi përfundimisht nga skena disa nga familjet e njohura arbërore, të cilat, në rrethanat e reja, me poste të ndryshme, në njëfarë mënyre u mbajtën të lidhura me pushtetin osman.

Ndër këto familje fisnike ishte edhe ajo e Gjon Kastriotit.

Por, kush ishin Kastriotët, të cilët në burimet historike shfaqen më vonë se shumë nga familjet bujare të kohës së tij, që përmenden si feudalë të vegjël në vitet 70 të shekullit XIII, ndonjëherë ndoshta më herët dhe, nga vinin ata?

Vlerësimi “se familja e Kastriotëve do të kishte mbetur me siguri e papërfillur siç kanë mbetur familje të tjera fisnike arbërore të mesjetës (me përjashtim të Muzakëve), po të mos kishte dalë nga gjiri i saj Gjergj Kastrioti Skënderbeu, sikur e relativizon shumë nga kundërthëniet që dalin nga burime të ndryshme që merren me gjenealogjinë e kësaj familje ku kërkohet që të vihet një baraspeshë shpesh të pamundshme midis namit të heroit kombëtar dhe prejardhjes së tij, sado që kjo e lë të hapur çështjen e shpjegimit të mbiemrit të tyre, edhe pse kohëve të fundit kjo lidhet edhe me atë të fshatit Kastriot, i cili ndodhet në thellësinë malore të Shqipërisë Lindore, 8 kilometra në veri të Peshkopisë, në Dibrën e Poshtme, brenda kufijve të mikrokrahinës apo bashkësisë krahinore të Qidhnisë, një nga nëntë “malet” e trevave dibrane.<sup>718</sup>

---

<sup>718</sup> Shih Frashëri, Kristo: “Gjergj Kastrioti Skënderbeu – jeta dhe vepra”, Tiranë 2002, faqe 54. Me këtë rast historiani shqiptar, heq dorë nga disa qëndrime të mëparshme të shfaqura në “Historinë e Popullit Shqiptar”, të botuara në vitin 1956.



Është interesant se fshati Kastriot, ka qenë i panjohur për gjithë historianët që janë marrë me historiografinë e Skënderbeut.<sup>719</sup> Kjo mbase ka bërë që të shfaqet i vonuar si argument i mundshëm, që si i tillë gjen mbështetjen te praktika qysh nga mesjeta kur bujarët arbërore kanë përdorur si mbiemër emrin e fshatit të tyre të hershëm. Këtë praktikë mund ta kenë përdorur edhe Kastriotët.<sup>720</sup>

Rreth praktikës së mbajtjes së dy emrave, një emri të parë që rrallë ishte emër kombëtar, dhe një mbiemër që ishte ai i fisit ose i katundit të vet, flet edhe Jireček. Vlerëson se mbiemrat Kastrioti, Balsha, Muzaka, Araniti dhe Shpata, janë emra katundesh që ekzistojnë ende në Shqipëri.<sup>721</sup>

Kështu, gjeneza e Kastriotëve nga Dibra, si të ardhur nga një katund i Matit (Shtjefën), që zihet ngojë nga K. Frashëri<sup>722</sup>, mbrohet edhe nga etnografi Mark Krasniqi. Këtë qëndrim ai e nxjerr nga përpunimi i shumë burimeve nga tradita popullore, të cilat origjinën e Skënderbeut e lidhin me katundin Kastriot të rrethit të Dibrës. Atje ka qenë i ati i tij.<sup>723</sup> Qëndrim i njëjtë mund të nxirret edhe nga “Memoria” e Muzakës.<sup>724</sup>

Se katundi Kastriot dhe Dibra e Madhe nuk mund të jenë referencë e vetme e origjinës së Kastriotëve, shihet edhe nga qëndrimi i luhatshtëm të vetë historianëve shqiptarë nga Tirana, të cilët fillimisht mbështeten pikëpamjen se Kastriotët vinin nga Kastrati, një katund nga Hasi i Kukësit<sup>725</sup>, ku thuhet se edhe emri i Kastriotëve duhet të ketë qenë Kastrat, po që ndikimi bizantin mund t’i ketë dhënë një formë të tillë.<sup>726</sup>

---

<sup>719</sup> Deri në fillim të shekullit XX, fshati Kastriot, kur atë e bëri të njohur, më 1903, një lexues nga Tirana i rivistës së Konicës “Albania”, pastaj, një vit më vonë, konsulli rus, Jastrebov, më 1904, ishte i panjohur për historianët.

<sup>720</sup> Shih “Albania”, London, 4/1903 dhe I. S. Jastrebov “Stara Srbija i Albanija”, në “Spomenik” të Akademisë Mbretërore Serbe, Beograd, vol.XLI, 1904, faqe 123,226-227.

<sup>721</sup> Shih: Jireček, K: “Forschungen“, Vëll. I, faqe 70.

<sup>722</sup> Frashëri, Kristo: “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, Tiranë 2002, faqe 54.

<sup>723</sup> Krasniqi, Mark: “Gjeneza Kastriote e disa fiseve shqiptare dhe malazeze sipas traditës popullore” në “Simpoziumi për Skënderbeun”, Prishtinë 1969, faqe 265-266.

<sup>724</sup> Shih Memoranda e Gj. Muzakës e përfshirë te CH. Hopf: “Chroniques greco-romanes etc.,” Faqe 301 si dhe te Xhufi, Pëllumb “Nga Paleologët te Muzakajt”,Tiranë 2009, faqe 365-457.

<sup>725</sup> Më gjerësisht shih “Historia e Shqipërisë”, botuar nga Universiteti i Tiranës më 1959, vëll. I. Krahas K. Frashërit, këtë qëndrim e mbronte edhe A. Buda dhe në përgjithësi historiografia shqiptare e asaj kohe.

<sup>726</sup> Lidhjen etimologjike të Kastriotit nga Kastrati e mbrojnë shumë autorë të huaj, ndër të cilët më të njohurit janë: “Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis Illustrantia etc”, vol II, Wien, 1916, dok, nr. 249; P.Luccari (Capioso risteretto degli Anali di Rausa) si dhe L. Ugolini (Pagine di storia veneta ai templi di Scanderbeg e de i suoi successori); L.V Thalloscy- C. Jirecek: “Zwei Urkunden aus Nordalbaninen”, në “Archiv für Slawische Philologie”, vol. XXI, Berlin 1988, ff 76-99, ribotuar në “Illyrisch-Albanische Forschungen”, I Band München und Leipzig 1916, faqe 136; Jastrebov, I. S. E. “Stara Srbija i Albanija”, në “Spomenik” (Srpska Kraljevska Akademija), vol, XLI, Beograd, 1904, faqe 123, 126, 127; Fermedijin (Acta Bosnae në “Monumenta Historam Slavorum Meridionalium”, vol. XXIII, Zagreb 1892, ribotuar në origjinal nga F. Noli “Scanderbeg”, New York 1942).

Kjo hamendje ka përcjellë edhe shumë autorë të tjerë, të cilët gjenealogjinë e familjes Kastrioti përpiqen që ta zhvendosin nga një katund (Kastrati, apo Kastrioti) në një ambient më të gjerë nga ai i Dibrës së Madhe apo i Hasit të Lumës, duke e ndërlidhur atë me Epirin, po edhe me Maqedoninë dhe Matin si një përkufizim më të gjerë historik prej nga bëhen përpjekje që të shihen sa më thellë rrënjët e fisnikërisë së saj qoftë edhe jashtë argumenteve të kapshme historike. Me këto pikëpamje, duke i parë të njëjta Epirin me Maqedoninë po edhe Albaninë, operojnë Barleti,<sup>727</sup> Bardhi<sup>728</sup>, Noli<sup>729</sup> dhe disa autorë të tjerë të huaj, të cilët përmendin *Ematinë (ex Aemathia)*, me të cilën mund të nënkuptohet edhe krahi- na e Matit, pavarësisht se në shumë raste ajo identifikohet edhe me Maqedoninë antike, që si e tillë i atribuohet edhe identifikimit të kurorës së Skënderbeut.<sup>730</sup>

Sidoqoftë, konteksti i ndërlidhur dhe për shumëçka i hapur i gjenealogjisë së familjes Kastrioti dhe shtrirjes së saj të paqartë në thellësinë historike, sikur kthi- llet paksa drejt një realiteti të prekshëm nga disa akte arkivore që merren me pas- qyrimin e gjendjes reale të pronave që zotëroheshin nga Gjon Kastrioti, siç ishin fshatrat Radostushë dhe Trebishtin, që ndodheshin në trevën e Dibrës,<sup>731</sup> prej nga nxirret përfundimi se Gjon Kastrioti, nga burimet e jashtme, kryesisht venedika- se, si feudal i fuqishëm shfaqet në skenën shoqërore dhe politike nga fundi i shekullit XIV dhe fillimet e të XV,<sup>732</sup> pikërisht në kohën e ndryshimeve të mëdha të cilat pasuan pas ndeshjes vendimtare të të krishterëve me Osmanët në Dardani, kur rënia e disa familjeve të njohura fisnike u përcoll me ngritjen e disa të tjerave të panjohura deri më atëherë, ose të tillave që silleshin midis njërit apo tjetrit zotim, duke përfituar nga rënia e njërit apo tjetrit.

Bazuar në njoftimet e Muzakës, ishte pikërisht Gjon Kastrioti, i cili nga i ati trashëgoi vetëm dy katunde të Qidhmës, i cili shfrytëzoi këto tronditje që të zgjerohet në mbarë trevën e Dibrës, gjë që brenda një kohe të shkurtë arriti deri në skajin jugor të saj, ku në lindje edhe arriti te kalaja e Sfetigradit.<sup>733</sup>

<sup>727</sup> Barleti, Marin: “*Historia e Skënderbeut*”, Tiranë, faqe 64.

<sup>728</sup> Blancus, F: “*Georgivs Castriotvs Epiensis vulgo Scanderbegh, Epirotarum Princeps etc.*” Venetiis, 1936, në shqip: F. Bardhi “*Skënderbeu*”, përktheu Stefan Prifti, Tiranë 1957, faqe 69.

<sup>729</sup> Noli, S Fan: “*Gjergj Kastrioti Skënderbeu 1405-1468*”, Tiranë 1967, faqe 58.

<sup>730</sup> Shih: Papa Kaliksti III më 1475: *ac Macedoniae principem Skanderbeg* (princit të Maqedonisë Skënder- beut); Johannes Jovinaus Pontanus: “*Quod, ni ex Macedonia Georgius Castriotus, conomento Skander*”.

<sup>731</sup> Shih aktet e Hilandarit të paraqitura nga K. Frashëri në “*Gjergj Kastrioti Skënderbeu – jeta dhe vepra*”, Tiranë 2002, faqe 65.

<sup>732</sup> Akti i parë që flet për Gjon Kastriotin del nga kancelaria e Venedikut dhe ka të bëjë me vitin 1406, ku le të kuptohet se ai tashmë ishte një “zot”(sundimtar) i fuqishëm në këto anë. (Schmitt, Jens Olivier: “*Skënderbeu*”, Tiranë 2009, faqe 39).

<sup>733</sup> Frashëri, Kristo: “*Gjergj Kastrioti Skënderbeut – jeta dhe vepra*”, Tiranë 2002, faqe 68.

Gjithnjë duke u bazuar në dokumentet venedikase, Gjon Kastrioti midis viteve 1406-1430, kur përfundimisht mundet nga forcat osmane të Muratit II, gëzonte autoritetin e Republikës së Venedikut nga e cila vlerësohej si sundimtar i fuqishëm, me të cilin duhej mbajtur marrëdhënie sa më të mira, edhe pse dihej se në këtë ndërkohë ai karshi Osmanëve ndodhej në një gjendje vasaliteti.<sup>734</sup> Këtë gjendje, pra vasalitetin, ia rikonfirmonte herë pas herë edhe Venedikut, prej nga bëhet e ditur se nga senjoria merrte porosi se ishte në interesin e tij që të mos i prishte marrëdhëniet e mira me sulltanin. Nga Venediku i thuhej, madje, se kur të vinte koha të prishej me Turqit do të kishte mirëpritje në zotërimet e Republikës dhe do të trajtohej si bir i mirë dhe i dashur i saj.<sup>735</sup>

“Nami” i mirë që gëzonte te Venedikasit si dhe mbështetja që i jepej atij, padyshim se u përshtatej venedikasve për interesat e tyre në këtë pjesë të rëndësishme të Adriatikut, mund të shihet edhe nga një deponim i Republikës së Venedikut te Papa që t’i kënaqte kërkesën e ambasadorit të zotit Gjon Kastrioti dhe të tjerëve “zotën” të viseve të Arbërisë (*ambasadoris domini Juani Castrioti et aliorum dominarum partium Albanie*).<sup>736</sup>

Në të vërtetë, qytetaria venedikase, që iu premtua, Gjonit do t’i jepet në maj të vitit 1413, pasi që paraprakisht ajo do t’i njihej edhe nga Raguzat, të cilën e kishte kërkuar, i bindur se në këtë mënyrë mund të gjente strehë nga stuhia që kishte filluar pas fitores së Mehmetit ndaj të bijve të Bajazitit, me ç’rast ai do të shpallet sulltan i vetëm i Perandorisë Osmane. Njohja e qytetarisë së Venedikut për Gjonin, praktikë kjo që senjoria e përdorte për të gjithë feudalët dhe kontët e tjerë nga Iliriku me të cilët bashkëpunonte, por të shumtën i shfrytëzonte për interesat e veta, shtrihej edhe mbi gjithë bijtë dhe trashëgimtarët e tij (*Quod siti civis venetiarum intus et extra, cum suis filiis et heredibus*).<sup>737</sup>

Në këto rrethana, në raportet osmane-venedikase, të cilat kalonin nëpër aleanca herë të hapura, herë të fshehta, megjithatë gjendja e Gjon Kastriotit paraqitej si një barometër i veçantë, jo vetëm për atë që ai duhej të kalonte me kujdesin që të përfitonte prej tyre sa më shumë që të ishte e mundur, por nga shkakut e limiteve, që duhej përherë të kiheshin parasysht, meqë nxirrmin nga loja fare me rrënime të pashmangshme madje, siç do të ndodhë me rastin e luftës veneturke të viteve 1428-1430, kur Gjon Kastrioti duke mos i përmbushur detyrimet e

---

<sup>734</sup> Shih

<sup>735</sup> Po aty, faqe 79.

<sup>736</sup> Po aty, faqe 68.

<sup>737</sup> Shih: *Acta Albania Veneta*, X, nr. 2280; Plasari, Aurel: “Skënderbeu”, Tiranë 2010, faqe 268.

vasalit ndaj sulltanit, siç ishin ato që t'u shkante në ndihmë me ushtarët e tij, Osmanëve ua krijoi bindjen se në njëfarë mënyre kishte marrë anën e Venedikut.<sup>738</sup>

Burimet e ndryshme historike të kohës, shpesh kundërthënëse, janë ato që fundit të Gjon Kastriotit i japin pamje të ndryshme nga ato të “shkëputjes nga vasaliteti osman”, meqë shpresonte se lidhja me Venedikun dhe Perëndimin në raport me Osmanët mund t'i siguronte diç më shumë, e deri te vlerësimi se ky mund të ishte një veprim i detyruar nga rrethanat, të cilat edhe ashtu e nxirrnin nga loja, gjë që ato duhej shfrytëzuar për ta gëzuar statutin e qytetarisë nga Venediku për vete dhe familjen.

Sidoqoftë, gjendja e Gjon Kastriotit nga humbja e tij e thellë nga ushtria e Isak bej Evrenozit në pranverën e vitit 1430, kur u detyrua të pranojë përuljen në mënyrë që para sulltanit të shpëtojë atë që mund të shpëtohej, paraqet një kapitull emblemantik, atë të fillimit të vendosjes dhe të zbatimit të regjimit të timarit në pjesët tjera të Arbërisë, me çka fillonte faza përfundimtare e shpronësimit të mëtejshme e fisnikërisë arbërore si dhe rrënimit i tyre nëpërmes pranimit të rregullave që parashtronte pushtuesi osman.

Ky ndryshim do të përcillet me futjen e shumë prej tyre në sistemin e tyre fillimisht si spahinj dhe subashë e deri te shkalla e pashallarëve dhe vezirëve. Ata që nuk do t'i nënshtrohen këtij rregulli, siç ishin Zenevizi i Gjirokastrës, i cili u vendos në ishullin e Korfuzit,<sup>739</sup> apo Nikollë Dukagjini i Danjës, i cili kërkoi strehim së bashku me shumë familje në Shkodër, që ishte nën mbrojtjen e Venedikut,<sup>740</sup> do të detyrohen që të braktisin vendin, ose të kërkojnë strehim në pjesët e thella malore, ku nuk mund të shkelte këmba e Osmanëve.

Nga shënimet e ndryshme hetohet që më 1431 zotimet e Gjonit, nën vasalitetin e sulltanit dhe të organizuara sipas regjimit të *timareve* figurojnë në *Defterin e Sanxhakut Arnavud* të vitit 835 të higjres, shfaqen në emrin “Yuvan”. Nga regjimi i timarit, megjithatë thuhet se përkohshëm u përjashtua vetëm krahina e Misies, e cila duket se tetë vjet më vonë e humb atë statut,<sup>741</sup> por si e tillë ajo do të kthehet në një referencë të rëndësishme të shumë ngjarjeve që lidhen me daljen në skenën historike të Gjergj Kastriotit Skënderbeut.

---

<sup>738</sup> Më gjerësisht shih *Fetihname* (shpallje e pushtimit) të Selanikut më 1430 te Feridun Bey “*Müseat üs-selatin*”, I,200 te Pulaha: “*Mbi gjendejn në vitet '20-'30*, 117-120.

<sup>739</sup> Shih shënimet e L. Kalkolondilit te K. Bozhari “*Lufta shqiptaro-turke në shekullin XV. Burime bizantine*”, Tiranë 1967, faqe 47-48.

<sup>740</sup> Shih: “*Dokumente rreth kryengritje shqiptare kundër pushtimit osman në vitet 30 të shek. XV*”, në: “*Studime historike*”, nr.1/1967, faqe 147-162.

<sup>741</sup> Shih: “*Hicri 835 Suret-i Defter-i Sancat-i Arvanid*, faqe 120; dhe Inihalçik, H: “*Arnavuluk'ta Osmanli Hakimiyetinin yerlesmisi ve Iskendr bey isyaninin mensei*”, Ankara 1954, faqe 675.

*Vilajeti Juvan-ili* (Vilajeti i Viseve të Gjonit domethënë të Gjon Kastriotit), ishte pjesë e një njësie të madhe feudale-ushtarake administrative, të quajtur *Sancak-i Arvanid* me kryeqendër Gjirokastrën, në përbërjen e të cilit kishte një numër të madh *kazash* dhe *nahijesh*, ndër të cilat u futën edhe zotimet e Kastriotëve me qendër në Rahonik (emër mesjetar i qytetit të Dibrës, që më vonë u përfshi në sanxhakun e Ohrit).<sup>742</sup>

Pranimi i vasalitetit osman nga një pjesë e feudalëve arbërorë, nën rrethanat e vendosjes së regjimit të timarit sipas regjistrimit mufasal, me të cilin fillonte *vendosja e feudalizmit ushtarak*, u përcoll me trazira dhe kryengritje të shumta, të cilat, nga shkaku se regjistri mufasal kishte lënë jashtë disa zona, siç ishte edhe krahina e Misies e Kastriotëve, domosdoshmërisht përfshinte edhe disa vasalet e sulltanit. Në këto rrethana, në vitin 1434, Gjon Kastrioti shihet i përfshirë në kryengritje në luftimet nën muret e Krujës.<sup>743</sup>

Edhe pse nga disa burime mësohet se kjo kryengritje i atribuohet AndreaThopisë që kishte humbur të gjitha zotimet, nuk përjashtohet bashkëpunimi i ngushtë me Gjonin, meqë pasi që kryengritja shuhet, me urdhrin e sulltanit, Kastrioti u zhvesh nga zotërimi i krahinës së Misies, me ç'rast ajo u kthye në një feud ushtarak “të pavarur” (nënkuptohej nga Sanxhaku Arvanid), jo të shkallës së ulët (*timar*), por të një shkalle më të lartë (*zeamet*).<sup>744</sup>

Nahija Misie, si e pavarur, megjithatë, krijoi një rrethanë të veçantë – atë të qeverisjes së saj nga një ushtarak turk, që nga banorët vendorë nuk e pranonin, por kërkonin që në krye të saj sërish të ishte një Kastriot, “ngatërrim” ky që nisi të merrte përmasat e një ashpërsimi që kërcënonte për një kryengritje tjetër, që si do të shihet, do të “qetësohet” me faktin që te sanxhakbeu Mustafa do të paraqitet i biri i Gjon Kastriotit, Skënderbeu.

Shfaqja e Skënderbeut te sanxhakbeu i Ohrit, Mustafa, si spahi timari, i cili kishte kërkuar që ai të ngarkohet *zaim* i krahinës së Misies, megjithatë nxjerr në pah faktin se ai në vitet 1435-1437 mund të ishte spahi në një timar të trevës së Dibrës. Kjo përmendet nga shumë historianë, të cilët mbështeten në disa dëshmi të autorëve osmanë si Ashik Pasha-zade dhe Saad-ed-Din, të cilët njoftojnë se Skënderbeu u caktua prej sulltanit si trashëgimtar i të atit, duke iu dhënë “vilajeti” që e pati, por pa e përcaktuar se a ishte fjala për “*Vilajetin e Gjonit*”, në

---

<sup>742</sup> Po aty.

<sup>743</sup> Shih: Frashëri, Kristo: “*Gjergj Kastrioti Skënderbeu – jeta dhe vepra*”, Tiranë 2002, faqe 115.

<sup>744</sup> Pulaha, S: “*Mbi gjendjen në vitet 20-30 të shek. XV në tokat shqiptare*”, në “*Studimet historike*”, nr.4/1970, faqe 111-157.

përmasat e zotimeve që përfshinte pronat e tij si vasal, apo për “*Vilajetin e Misies*”, që përfshinte një pjesë të vogël të tyre.<sup>745</sup>

Kjo paqartësi bëhet edhe më e madhe, kur atyre u shtohet e dhëna që lidhet me emërimin e Skënderbeut nga ana e sulltanit subash të Kazasë së Krujës, shkallë kjo më e lartë nga ajo e *zaimit* të Misies, gjë që kjo nënkuptonte edhe titullin “bej”, që Skënderit i erdhi bashkë me emërimin qeveritar i Krujës.<sup>746</sup>

Bashkëkohësi i Skënderbeut, R. Volaterranus, njofton se menjëherë pas vdekjes së Gjon Kastriotit, sulltan Murati i dorëzoi Skënderit mbretërinë atërore.<sup>747</sup>

Ky njoftim dhe disa të tjerë të kësaj natyre, po ashtu, hap edhe çështjen e vdekjes së Gjon Kastriotit, që po të jetë sipas shënimit paraprak që lidhet me atë të emërimit nga sulltan Murati subash i Krujës dhe me titullin “bej”, atëherë ai duhet të ketë vdekur në maj të vitit 1437.<sup>748</sup>

Është, megjithatë, një njoftim tjetër nga Venediku, i datës 28 mars 1438, që ka të bëjë me kërkesën e Gjon Kastriotit Republikës së Venedikut për qytetarinë e saj për djemtë e vet. Meqë dokumenti i Venedikut është i shoqëruar edhe me të dhëna të tjera, kjo ka mjaftuar që disa nga historianët të vinë deri te “një kompromis” midis burimeve osmane dhe atyre perëndimore, me ç’rast Gjon Kastrioti thuhet se duhet të ketë vdekur pas 28 marsit të 1438 dhe para 15 marsit 1439.<sup>749</sup>

Paqartësia e vdekjes së Gjon Kastriotit, do të përcillet edhe me një paqartësi tjetër, që ka të bëjë me kohën e subashllëkut të Skënderbeut në Krujë, e cila duhet të ketë filluar diku në verën e vitit 1437 për të përfunduar në tetorin e vitit 1438, pasi që në defterin e Krujës si subash shënohet një farë Hazër beu, i cili kishte qenë subash edhe para emërimit të Skënderbeut.<sup>750</sup>

Është fjala për pesë vite, të cilat plotësojnë kohën deri te lufta e Nishit e vitit 1443, kur Skënderbeu përfundimisht do të shkëputet nga Sulltani, vite këto që duhet t’u japin përgjigje gjithë atyre me të cilat Gjergj Kastrioti Skënderbeu do të futet në histori në mënyrë madhështore.

---

<sup>745</sup> Shih: Kramers, J.H: “*Encyclopedia of Islam*”, vol. III, Leyden, 1936, faqe 466; Noli, Fan Stilian: “*Gjergj Kastrioti Skënderbeu*”, Tiranë 1957.

<sup>746</sup> Shih njoftimet e Ashik Pashë-zadesë, Mehmet Neshtrit dhe Rrustem Pashasë të përfshira te vepra e K. Frashërit “*Gjergj Kastrioti Skënderbeu*”, Tiranë 2002, faqe 118.

<sup>747</sup> Shih: “*Commentarium Urbanorum Duodequadragesima*”, Romae, Joannes Besicken Alemanus, 1506.

<sup>748</sup> Shih: Stojanović, Lj: “*Stari Srpski zapisi i natpisi*”, Beograd 1902, faqe 87; Dujčev, Ivan: “*Giorgio Castriota Scanderbeg nella letteratura slava contemporanea*”, në “*V Convegno Internazionale di Studi Albanesi*”, Palermo 1968. Akti 1969, faqe 247-257.

<sup>749</sup> Shih Frashëri, Krishto: “*Gjergj Kastrioti Skënderbeu*”, Tiranë 2002, faqe 119.

<sup>750</sup> Po aty, faqe 120.

Këto vite, megjithatë, duket se nuk do të kenë qenë të qeta, meqë sipas Nolit në vitin 1438 përgatitej një “kthesë e re”,<sup>751</sup> që sipas shumë burimeve osmane kishte të bënte me projektimin e një kryengritje antiturke prej Gjon Kastriotit dhe të birit, që drejtpërdrejtë i atribuohet “Iskënderit”, pra Skënderbeut,<sup>752</sup> edhe pse janë burimet osmane ato që sa i përket pjesëmarrjes së drejtpërdrejt të Skënderbeut në kryengritjet e viteve 1438/9, shfaqen me shumë e shumë kundërthënie, ku në shumë prej tyre, përshkruhen betejat, fitoret osmane, por jo edhe drejtimi i tyre prej Skënderbeut. Ka disa burime të tjera, me anën e të cilave bëhet e ditur që ai nga 1438-1443, herë pas herë të ketë shërbyer edhe në pjesë të tjera, si në Siri(Sham)<sup>753</sup> dhe Nikopojë (Bullgari),<sup>754</sup> pa i shkëputur lidhjet me vendlindjen, pandehmë kjo që përjashtohet nga disa historianë shqiptarë, të cilët mbrojnë qëndrimin se Skënderbeu nuk u largua nga Arbëria, por qëndroi aty në detyrën e subashit të Dibrës.<sup>755</sup>

Sidoqoftë, vitet 1438-1443, të cilat shënojnë kohën e shkëputjeve të Skënderbeut nga sulltani dhe do të ngrehë krye kundër tij, lidhen me një ngjarje të rëndësishme të kohës: me Koncilin e Ferrara-Firencës, me dekretin e dalë prej tij për “bashkimin e kishave” si dhe planet që vendet e krishtera të përgatisin një kryqëzatë të përbashkët kundër Osmanëve jo vetëm t’u pengohet depërtimi drejt Europës që kishte filluar prej kohësh dhe ecte shpejt, por të çlirohen edhe vendet në Azi të pushtuara prej tyre. Dekreti i dalë nga ai Koncil, i nënshkruar më 5 korrik 1439 nga papa Eugjen IV, perandori i Bizantit, Joan VII Paleolog, patriku i Kostandinopojës, Josif dhe peshkopi i Nikesë, Visarion (Bessarione), krahas “bashkimit të kishave” parasheh edhe restaurimin e Perandorisë Romane nëpërmjet të cilit të realizohej dëbimi i “të pafeve” nga Europa dhe deri nga ato pjesë të Azisë që dikur i patën përkitur Perandorisë.<sup>756</sup>

Ky pra mund të ishte një moment shtesë dhe tejet domethënës që mund të ketë ndikuar që Skënderbeu t’i kthehet edhe më me përkushtim luftës kundër

<sup>751</sup> Shih Noli, Fan S: “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, Tiranë 1957, faqe 80-83.

<sup>752</sup> Më gjerësisht shih te Plasari, Aurel “Skënderbeu”, Tiranë 2010 faqe 292 njoftimet nga Hoxha Sadeddin për vitin 842 të hegrisë (14 qershor 1438 – 3 qershor 1439) që përmend ngritjen kryet të “Iskenderit sojkeq”, që “i verbuar nga krenaria gaboi në rrugën e tij duke shtrirë dorën në tokat islame të atyre kufijve”.

<sup>753</sup> Rreth qëndrimit të përkohshëm të Skënderbeut në Sham (Siri) si sanxhak-be shih Sh. Sami-bej Frashëri në “Kamus al-a’ Lam” (zëri – Skënderbeu para vitit 1443).

<sup>754</sup> Shuteriqi, Dhimitër: “Dy dokumente të kohës së Skënderbeut”, në “Drita”, 25 janar 1965.

<sup>755</sup> Më gjerësisht rreth qëndrimit se Skënderbeu gjatë viteve 1438-1443, subash në Dibër, shih Frashëri, Kristo “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, Tiranë, 2002, faqe 120-124; Pulaha, S “Mbi gjendjen në vitet ’20-’30 të shek. XV në tokat shqiptare dhe mbi qëndrimin e klasës feudale kundrejt pushtimit osman”, në Studime Historike, Tiranë 4/1970, faqe 136-141.

<sup>756</sup> Më gjerësisht rreth Koncilit të Ferrara-Firencës shih: “Monumenta Conciliorum Generalium spec. XV etc” si dhe te Erhard: “Geschichte des Wiederaufblühens”.

Perandorisë Osmane, si diçka që i takonte gjithë qytetërimin perëndimor, luftë kjo që mund të bëhej vetëm po që se mbështetej nga të gjithë ata që janë në gjendje të bashkohen përfundimisht kundër një armiku të përbashkët.

## SKËNDERBEU DHE FILLIMET E LUFTËS KUNDËR OSMANËVE

Jeta dhe vepra e Gjergj Kastriotit Skënderbeut, bir i një feudali të Arbrit, Gjon Kastriotit, sundimtar i Krujës, i cili brenda një kohe të shkurtër kishte ndër-rruar tri herë kryqin, nga ai ortodoks në katolik dhe anasjelltas, flet për njërën ndër epokat më të rëndësishme të historisë së popullit shqiptar në përgjithësi në luftën e gjatë për identitet kombëtar dhe shtetëror, e lidhur ngushtë për dësh- mimin e identitetit të krishterë perëndimor dhe përkatësisë së tij në rrethanat dhe në hapësirën e asaj që në kontinentin e vjetër, në planin shpirtëror do të pas- qyrohet ndeshje e qytetërimeve, ndërsa në atë politik, kufi i sferave të interesit Perëndim-Lindje i përmasave gjeostrategjike.

Në të vërtetë, po mos të ishte kthesa e një ushtaraku të ri - që do të pasojë me largimin nga ky post i lavdisë për t'iu kthyer qenies së vet në shërbim të atdheut, por edhe asaj që së shpejti do të paraqesë digë mbrojtëse në luftë kundër depër- timeve osmane - me siguri se jeta dhe vepra e ushtarakut të quajtur Skënderbe, i cili në saje të sukseseve të jashtëzakonshme brenda një kohe të shkurtër ngrihet në shkallën e lartë të hierarkisë ushtarake të Perandorisë, pa marrë parasysh se në ç' lartësi do të përfundonte, do të mbetej në kornizat e të natyrshmes, si shumë e shumë të tjera, pjesë e historisë së Perandorisë Osmane.

Pikërisht pse Skënderbeu braktisi një betejë në shërbim të Perandorisë Os- mane, atë të Nishit në vitin 1443, e drejtuar nga Hungarezi Gjon (Janosh) Huni- jadi, e cila po zhvillohej në hapësirën perëndimore (në Dardani), prej nga ai vinte, për t'iu kthyer atdheut dhe këtë do ta bëjë duke hyrë në luftë me Peran- dorinë më të madhe të kohës, në të cilën ishte ngritur, kjo do të paraqesë atë kthesën e madhe historike që do ta ngritë në hero kombëtar të Shqiptarëve dhe në simbol të paparë deri më atëherë, në luftë kundër Perandorisë Osmane.

Kjo ndodhi në kohën kur Perëndimi ishte përfshirë nga një panik i përgjith- shëm dhe, të shumtën, mendonte si të zgjidhte mjetet më të përshtatshme të dre- dhive për t'i ndalur ata pa i shkuar kujt ndërmend që të merrej me një luftë të përbashkët mbrojtëse kundër tyre, e cila njëherësh do të kthehet në një luftë për mbrojtjen e qytetërimin të krishterë perëndimor për t'u vlerësuar me të drejtë si



njëra ndër më të rëndësishmet dhe më të fuqishmet e kohës. Dhe në ato rrethana të ankthit të madh, kur pas Koncilit të dështuar të Ferraro-Firencës së vitit 1439 rreth një kisha të përbashkët që do të drejtonte luftën antiosmane kambanat e kishës Notër Dam të Parisit shënonin vetëm humbjet e betejave nga Osmanët nëpër fronte të ndryshme, fare papritmas kumbimin mortar do ta kthejnë në triumfues nga lajmet që erdhën nga një kështjellë, thuajse e panjohur për Europën, e quajtur Krujë. Aty flamuri osman hiqet dhe zëvendësohet me shqiponjën dykrerëshe të derës së Kastriotëve. Nuk do të vonojë e ai flamur për më shumë se një çerek shekulli do të kthehet në simbol të shtetit të Arbrit, por do të kthehet edhe në simbol shprese të krishterimit perëndimor në luftë kundër depërtimeve osmane dhe të islamit në kontinentin e vjetër.

A ishte Skënderbeu dhe kthesa historike, në ato rrethana përnjëmend një veprim i matur që më parë patriotik i një ushtaraku me lavdi të përmasave perandorake në shërbim të borxhit ndaj atdheut, tashmë të robëruar si edhe vendet e tjera të juglindjes së kontinentit të vjetër që bashkërisht kishin hyrë nën flamurin e gjelbër, të cilit duhej t'i kthehej fronti i rrënuar - veprim ky që pastaj, nga jashtë do të krahasohet me atë të *“engjëllit shpëtimtar të krishterimit”*, siç do të shprehën gjithë lavdi, disa nga kronistët e kohës pa ngurruar që ta krahasojnë edhe me profet dhe të ngjashme?<sup>757</sup> Apo, fjala ishte për një veprim të pritur të një arbërori me bindje të thellë patriarkale, që as ngritja në postin më të lartë ushtarak, as fama dhe shkëlqimi i një perandorie, ndër më të fuqishmet e kohës në botë, e cila mbante nën fronin e vet tri kontinente dhe as përkëdhelja e sulltanit dhe të tjerat nuk do të jenë në gjendje ta shërojnë nga “kodi” patriarkal i hakmarrjes, në mënyrë që një ditë të marrë hak ndaj atij që ia kishte nënçmuar familjen dhe atdheun?<sup>758</sup>

<sup>757</sup> Rreth jetës dhe veprës së heroit kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, vetëm gjatë jetës së tij, nga autorë dhe kronistë europianë, në gjuhë të ndryshme, janë shkruar me dhjetëra vepra zhanresh të ndryshme. Ndër to ka edhe ato që arrijnë shkallën e apoteozave. Më vonë do të shfaqen edhe studime dhe kronika të shumta, ku Skënderbeut vazhdojnë t'i njihen edhe meritat e mbrojtësit të krishterimit dhe të ngjashme, po ku nuk harrohet përkatësia arbërore. Në shekullin nëntëmbëdhjetë, në kohën kur propaganda hegjemoniste serbe do të mundohet të rrënojë historinë e përkatësisë perëndimore të Shqiptarëve dhe të kontributit të Shqiptarëve në mbrojtje të tij, do të përpiqen ta përvetësojnë Skënderbeun, duke u munduar ta paraqesin herë si malazias, herë boshnjak e herë edhe maqedonas madje! Por, këto spekulime, do të mbesin pa ndonjë jehonë as në planin historik e as në atë politik.

<sup>758</sup> “Tezën” se Skënderbeu, kur do ta braktisë betejën e Nishit dhe do të kthehet në Shqipëri, gjoja nuk ka pasur qëllime të tjera pos atyre të hakmarrjes, që lidhen me mentalitetin fisnor shqiptar të hakmarrjes, të ngjashëm me atë të cubave, e hodhi historiani zviceran, Oliver Jens Schmitt, në librin *“Skënderbeu”*, të botuar në gjuhën shqipe në Tiranë, në vitin 2009. Është fjala për një studim me pretendime të monografisë, të përkthyer nga Ardian Klosi, i pabotuar në gjuhën gjermane. Schmitt, po ashtu, hedh edhe tezën se Skënderbeu ka qenë një vasal i Napolit dhe i nënshtruar i Venedikut dhe shumë e shumë hipoteza të tjera pezull, ose që shfaqenkonstrukte të shkëputura nga dokumentet dhe burimet e dorës së dytë dhe të ngjashme. Libri u kritikua

Shtruarja e këtyre dilemave është e drejtë edhe përkundër vlerësimit se fjala është për një monument të qëndrueshëm dhe të madh të përmasave të brendshme dhe të jashtme, atyre kombëtare dhe ndërkombëtare, që i ka bërë ballë me sukses sprovës së kohës dhe asaj të historisë thuajse i vetmuar, pse ka ardhur aty ku nuk është pritur dhe ngase nuk ka qenë i përsëritshëm. Andaj, pikërisht si i tillë dhe këtë oreol, ballafaqimi me veprën e tij, paraqet më tepër se një rilexim të një epoke të lavdishme, që duhet shqyrtuar dhe rishqyrtuar përherë për t'u kuptuar dhe interpretuar në përputhje me atë se cila ishte ajo shtysa e brendshme, po edhe e jashtme, dhe cilët ishin ata faktorë vendimtarë që do t'i japin fuqi sjelljes së tij me të cilën do të vihet në veprim kthesa e madhe dhe të ngjashme, në vend se të mbetet vetëm imazh frymëzues, ku ai përherë do të prodhojë krenari.

Hapja e këtij kundrim mund të qesë në pah pashmangshëm edhe vlerësimin se Gjergj Kastrioti Skënderbeu, si personalitet ka pasur idealin e madhështisë dhe vullnetin për fuqi, që mund ta kenë vetëm njerëzit e rrallë, nga i cili ai është udhëhequr dhe i ka mbetur besnik deri në pikë të fundit, në shërbim të një qëllimi po ashtu të lartë për t'u jetësuar, që e gjitha mund të lidhet me krijimin e një qendre të re perëndimore të rezistencës në atdheun e tij në përputhje me frymën që kishte ngjallur Koncili i Ferrara-Firences, si “koncil i bashkimit” të kishave (Romës dhe të Kostandinopojës), qendër kjo që kishte shumë nga parakushtet e nevojshme për diçka të tillë.<sup>759</sup>

---

nga një pjesë e historianëve shqiptarë, ndër të cilët duhet dalluar Kristo Frashërin dhe librin “*Skënderbeu i shpërfytyruar nga një historian zviceran dhe disa analistë shqiptarë*”, që iu kushtua kësaj çështje. Përpjekjet e kësaj natyre, për ta dëmtuar imazhin e Skënderbeut nuk janë të reja. Të tilla ka pasur edhe në të kaluarën. Njëri ndër autorët që në këtë drejtim ka qenë dhe mbetet frymëzues dhe me gjasë do t'i ketë shërbyer edhe Schmittit, është historiani anglez i shekullit XVIII, Eduard Gibson dhe vepra e tij “*History of the Decline and Fall Roman Empire*” (*Historia e muzgut dhe e rënies së Perandorisë Romake*), botuar në Londër më 1900, i cili pos të tjerash për Skënderbeun flet me përbuzje pse “*karrierën e tij do ta fillojë si tradhtar dhe dezertor ndaj sulltan Muratit II*” dhe të ngjashme, me të cilin Fan S. Noli do të merret gjerësisht në historinë e Skënderbeut “*Gjergj Kastrioti Skënder-beu*”, të botuar në Boston më 1947 dhe të përkthyer dhe të botuar në gjuhën shqipe në Shqipëri, në vitin 1967.

<sup>759</sup>Koncili i Ferrara-Firences u mbajt në vitin 1439 në Firencë nën thirrjen e papë Eugjenit IV që për moto kishte “koncilin e bashkimit”. Në këtë koncil morën pjesë vetë Papa Eugjen IV, perandori i Bizantit Joan VII Paleologu me të vëllanë Djimitër, patriarku i Kostandinopojës Josifi, peshkopi i Nikesë Visarion (Bessarione), si dhe shumë klerikë dhe përfaqësues të të gjitha patriarkanave të tjera të Lindjes. Në Firencë më 5 korrik 1439, pas një debati të gjatë disamujsh, u nënshkruar dekreti historik i “bashkimit” të Kishave. Dekreti u lexua publikisht në kishën katedrale të Firences. I hartuar njëherësh në latinisht dhe greqisht, krahas bashkimit të kishave, dekreti parashihte edhe restaurimin e Perandorisë Romane nëpërmjet të cilit të realizohej dëbimi i “të pafeve” nga Europa dhe deri nga ato pjesë të Azisë së vogël që dikur i patën përkthyer Perandorisë. (Më gjerësisht rreth këtij bashkimi shih: “*Monumenta Conciliorum Generalium spec. XV etc.*”; Erhard: “*Geschichte des Wiederaufblünes*”; Cecconi: “*Storia del Concilio, I (Antecedenti)*”; Hefele: “*Historie des conciles*”; Chiaroni: “*La stisma greco e il Concilio di Firenze*”; Geanokopulos: “*The Council of Florence*”; Gill: “*Eugenius IV: Pope of Christian Union*” dhe “*The Council of Florence, Firenze e il concilio del 1439*”; “*Christian Unity. The Council of*

Ky qëllim i lartë madje do të theksohet nga shumë e shumë studiues dhe personalitete të rëndësishme të kohës që janë marrë me të, ku edhe lufta kundër Osmanëve dhe përpjekjet për krijimin e shtetit të Arbrit bashkë me përkushtimin e atij që duhet të marrë përsipër rolin e mbrojtësit të qytetërimit perëndimor dhe të krishterimit, janë parë në shërbim të tij.

Krahas këtyre kundrimeve, që tashmë kanë kaluar në stereotipe të pashmangshme, jeta dhe vepra e Skënderbeut ngërthen edhe një tjetër – atë të idesë së zhvendosjes së kështjellës tashmë në rënie e sipër të Kostandinopojës nga brigjet e Bosforit, ku e kishte vendosur perandori dardan-ilir, Kostandini i Madh, para dhjetë shekujsh, me bindjen se kjo qendër e re në Krujë, të vazhdonte famën e Trojës së dikurshme, në mënyrë që prej andej jo vetëm ta mbrojë kryeqendrën e Perandorisë, por në frymën e Koncilit të Ferrara-Firences të bashkimit të kishave dhe të perëndimit rreth një lufte të përbashkët antiosmane, edhe ta kthejë në një Romë të re, prej nga Perëndimi i krishterë do të jetë në gjendje t’u bëjë ballë sulmeve osmane në mënyrë që një ditë edhe të rikthehet ku kishte qenë.

Edhe pse rreth konceptit skënderbegian që Kruja dhe Arbëria si “Romë e re” të kthehen në një bastion të ri të krishterimit botëror, që do ta zëvendësonte Kostandinopojën, që kishte filluar të kapitullonte para islamit, nga mungesa e ndonjë prononcimi ose plani të shpallur atëherë ose më vonë, duket një iluzion, megjithatë janë pikërisht stereotipet e njohura për jetën dhe veprën e Skënderbeut, me të cilat jemi mësuar të ballafaqohemi deri më tash, ato që mund t’i hapin rrugë një të menduarit se Skënderbeu kryekreje mund të jetë udhëhequr nga ideja e zhvendosjes së Kostandinopojës në truallin arbëror (në Krujë) si një mundësi reale, që në luftë me Osmanët Arbëria e një misionarizimi të ri (e quante jo rastësisht Epir dhe Maqedoni), të kthehej në një “kështjellë”, ku perëndimi do të bashkohej pas rënies së Kostandinopojës.

Sadoqë kthimi i tij në atdhe dhe lufta që ia shpalli Perandorisë Osmane nuk ishte jashtë idesë që kështjella e Bizantit, Kostandinopoja si “Romë e re” të zhvendosej nga Bosfori në Arbëri (Krujë), ide kjo që duhet të merret parasysh, paçka se ajo thyen stereotipet e vlerësimeve të deritanishme për Skënderbeun nga heroit kombëtar, ai evropian dhe “kalorësi i krishterimit” e të ngjashme, ndërkohë që edhe historisë së asokohshme i jep një domethënie tjetër, megjithatë është i domosdoshëm një kalim sado i shpejtë nëpër rrethanat të cilat do të kalojë djaloshi i quajtur Gjergj Kastrioti nga koha e pengut deri tek lirimi, kohë kjo jo

---

*Ferrara-Florence; Chitarin: “Greci e latini al Concilio di ferrara-Firenze”; B. De la Bronquiere: “Voyage d’outre mer”, Paris 1895, etj.).*

gjithaq e gjatë, por shumë e ngjeshur për nga zhvillimet, ku mund të dalë në pah faktori kyç që do të ketë ndikuar në atë veprim, i cili do të marrë përmasat e një kthese të madhe historike, e ku nuk përjashtohet edhe ideja e kthimit të Arbërisë në një “Romë të re”, që do ta zëvendësojë Bizantin e shembur?

## SKËNDERBEU DHE SHTETI I BASHKUAR ARBËROR

Kthimi i Skënderbeut në Arbëri në vitin 1443, kur u largua nga beteja e Nishit, me ç’rast kjo ia mundësoi fitoren ushtrisë hungareze të Hunijadit ndaj Osmanëve dhe fillimet e kryengritjes së përgjithshme që ai shpalli, solli ndryshime të rëndësishme në procesin politik të historisë së Arbërisë, me çka u rifillua rruga e procesit të formimit të shtetit të bashkuar arbëror, që do të përfshinte hapësirën e tri mbretëritë antike: atë maqedonase, epirotet dhe dardane, të cilin pushtimi osman e kishte ndërprerë gjysmë shekulli më parë.<sup>760</sup>

Pikënisje e rifillimit të këtij procesi, si rrethanë, u bë kryengritja e suksesshme e nëntorit 1443. Ndërsa, si institucion, shërbeu “Lidhja Shqiptare e Lezhës” e marsit të vitit 1444.<sup>761</sup>

“Lidhja Shqiptare e Lezhës”, e cila merret si bazë e themelimit të shtetit të Skënderbeut, nuk ishte “lidhje princash”,<sup>762</sup> por një lidhje zotërish, bujarësh dhe krerësh të njohur të familjeve ose krahinave. Bujarët morën përsipër barrën të ndihmonin luftën çlirimtare me ushtri dhe me të holla, por të drejtat feudale në zotërimet e tyre partikulariste i ruajtën për vete. Ata ruajtën ushtrinë dhe kalatë. E njëjta gjë ndodhi edhe me krerët e malësive (ose të *maleve*, siç quheshin në atë kohë bashkësitë krahinore malore), të cilat do ta ndihmonin luftën vetëm me forca njerëzore, kurse brenda trevës së tyre do të vazhdonin të qeveriseshin sipas së drejtës zakonore vendore.<sup>763</sup> Vetëkuptohet se ata ruajtën të drejtën të largohejshin pa pasur asnjë ndëshkim apo pasojë.<sup>764</sup>

Pra, në Lezhë Skënderbeu u zgjodh kryetar i Lidhjes *vetëm* sa i përkiste luftës së përbashkët kundër turqve osmanë. Ai që zot feudal vetëm në zotërimin e

---

<sup>760</sup> Frashëri, Kristo: “Skënderbeu – jeta dhe vepra”, Tiranë, 2002, faqe 176.

<sup>761</sup> Po aty, faqe 176.

<sup>762</sup> Fan Noli: “Vepra”, 4, 1947, faqe 66.

<sup>763</sup> Frashëri, Kristo: “Skënderbeu – jeta dhe vepra”, Tiranë, 2002, faqe 176.

<sup>764</sup> Luarasi, A: “Shteti dhe e drejta shqiptare në shtetin e Skënderbeut”, Tiranë, 1998, faqe 128-130.

vet dhe komandant i ushtrisë së Lidhjes vetëm gjatë luftës. Në gjirin e Lidhjes ishte vetëm një “*primus inter pares*” (i parë ndër të barabartët).<sup>765</sup>

Me thellimin e luftës, kjo gjendje nuk ishte më e tillë që t’u përgjigjej de-tyrave të reja. Pushteti partikularist i bujarëve, e drejta e imunitetit që ata e gëzonin, rivalitetet që kishin midis tyre dhe lakmitë për të rrëmbyer tokat në zotërimet fqinje, qenë pengesë për zhvillimin e mëtejshëm të luftës, e cila kërkonte mobilizimin e të gjitha forcave njerëzore dhe burimeve materiale të vendit. Ky mobilizim mund të bëhej vetëm me përqendrimin e pushtetit politik.<sup>766</sup>

Në të kundërtën, pavarësia e veprimeve dhe e drejta për t’u larguar nga Lidhja Shqiptare, siç do të ndodhë më 1447 me largimin e Pjetër Spanit dhe Gjergj Dushmanit prej saj në kohën e konflikteve me Venedikun, ishte një rrezik i përhershëm për Skënderbeun. Ky rrezik bëhej edhe më i madh kur qëndrimin e lëkundshëm të bujarëve e nxitnin osmanët dhe e shfrytëzonin venedikasit, siç ishte qëndrimi i bujarëve të fuqishëm Gjergj Arianiti dhe Dukagjini.<sup>767</sup>

Por, do të jenë fitoret e rëndësishme të Skënderbeut, veçmas ato që korri kundër Sulltan Muratit II nën muret e Krujës, me të cilat ai e zhdëmtoi humbjen që kishte pësuar dy vjet më parë në Sfetigrad, të cilat filluan t’ia rrisnin prestigjin në masat e gjera të popullsisë, ndërkohë që bujarët, të cilët gjatë fushatës së Krujës iu bashkuan Sulltanit, filluan të shihen si tradhtarë. Madje, prestigji po u binte edhe bujarëve: Dukagjinit, Arianitit e Muzakës, të cilët pothuajse qëndruan manash përballë përlëshjeve të përgjakshme që u zhvilluan me turqit në afërsi të zotërimeve të tyre.<sup>768</sup>

Natyrisht se në këto rrethana, kur disa bujarë bënin sehir, disa të tjerë hanin me dy lugë, e kishte edhe asi që kishin kaluar në anën e Osmanëve, Skënderbeut iu desh që të “shkelte” një pjesë të marrëveshjes së Lidhjes Shqiptare të Lezhës, veçmas atë që kishte të bënte me kalimin e pushtetit partikularist të bujarëve feudalë. Kjo ndërmarrje filloi me organizimin e ushtrisë, e cila do të ishte në gjendje që t’u bënte ballë sfidave tepër të rënda.

Shumë autorë, duke përfshirë edhe biografët e tij (Barleti), bëjnë të ditur se Skënderbeu nga viti 1447, pra kur fillojnë të çarat e para në Lidhjen Shqiptare të Lezhës, nga e cila pas katër vitesh ai ndahet, mblodhi një ushtri prej rreth 15 ushtarësh, 3 mijë prej të cilëve përbënin gardën personale, që ishin luftëtarë të zgje-

---

<sup>765</sup> Frashëri, Kristo: “Skënderbeu - jeta dhe vepra”, Tiranë, 2002, faqe 177.

<sup>766</sup> Po aty, faqe 177.

<sup>767</sup> Po aty, faqe 177.

<sup>768</sup> Po aty, faqe 177.

dhur e të gatshëm për betejat më të vështira. Kjo nënkuptonte ngritje profesionale dhe përshtatjen në rrethanat e luftës, të cilat ishin tepër sfiduese kur kihej parasysh se luftohej me një armik të fuqishëm, ndër më të fuqishmit në botë, që kishte potencial të madh ushtarak dhe po ashtu armatim të bollshëm, që ishte në gjendje ta shtonte në përputhje me nevojat. Meqë ushtria e Skënderbeut, e formuar në bazë të vendimit të Kuvendi të Lezhës, kishte karakter federal dhe nuk ishte e aftë të ballafaqohej me njësitë elite osmane, të përgatitura për luftime të gjata, Skënderbeu e pati të domosdoshme organizimin e një ushtrie të re.<sup>769</sup>

Si ushtarak i cili ishte ngritur në ushtrinë osmane dhe që e njihte shumë mirë artin e saj ushtarak, Skënderbeu iu vu punës që të aftësonte forcat që kishte, të ishin në gjendje që në përputhje me rrethanat të bënin edhe luftën me armikun, duke zbatuar strategjinë e njohur të luftës partizane, të sulmeve të befasishme dhe të tërheqjes. Kështu, në vija të përgjithshme ushtria e Skënderbeut ndahej në dy pjesë: në ushtrinë e përhershme, duke përfshirë edhe gardën pretoriane, në të cilën mbizotëronte kalorësia, e armatosur lehtë, e cila ishte shumë e lëvizshme dhe e gatshme për veprime të paparashikuara.

Krahas kësaj, Skënderbeu kishte edhe ushtrinë ndihmëse, e cila përbëhej nga çeta fshatarësh, që mobilizoheshin sa herë i thërriste Skënderbeu. Detyra e tyre ishte të sulmonin prapavijat e ushtrisë osmane, të mbyllnin rrugët me anën e pusive, të dëmtonin karvanët që e furnizonin armikun me ushqime dhe me armatime.<sup>770</sup>

Zakonisht, në ushtrinë ndihmëse merrnin pjesë vullnetarët nga bashkësitë e lira krahinore, në bazë të parimit “burrë për shtëpi”. Me mbarimin e luftimeve, pjesëtarët e këtyre çetave ktheheshin në shtëpitë e tyre, ku punonin tokën me parmendë duke mbajtur me vete edhe armët, të gatshëm t’i përgjigjeshin thirrjes së Skënderbeut.<sup>771</sup>

Kuadrot ushtarake (oficerët) nuk kishin grada. Ata quheshin *kapedanë*, nga latinishtja *capitanes*. Ata ndaheshin në dy kategori: në komandantë të formacioneve të mëdha, që quheshin *kapedanë* të Skënderbeut, dhe në kapedanë të thjeshtë, të cilët vareshin nga kapedanët e Skënderbeut.<sup>772</sup>

---

<sup>769</sup> Po aty.

<sup>770</sup> Po aty, faqe 193.

<sup>771</sup> Barleti, Marin: “Skënderbeu – jeta dhe vepra”, Prishtinë, 1968.

<sup>772</sup> Franco, Demetri: “*Commentario dell Cose dei Turchi e del Signor Giorgio Scanderbeg*”, Venetia, 1539. Aty thuhet: Moisiu i Dibrës *capitno di Scanderbeg* (faqe20), ose Muzak Thopia *cognato et capitano suo (kumati dhe kapedani i tij)*, faqe 19, ose Moisiu dhe Gjurica *sui capitani* (faqe 9). Vetë Skënderbeu u ngarkua nga Kuvendi i Lezhës me detyrën e kapitenit të përgjithshëm *capitano generale di tutti li altri*, pra Kryekapedan (faqe 9).

Disa nga historianët e vonshëm, të cilët shfrytëzojnë burimet e arkivave të kohës, veçmas ato të Raguzës, Papatit dhe Venedikut, vlerësojnë se ushtria e Skënderbeut nuk kishte më shumë se 6 mijë trupa të gatshme për luftë, ndërkohë që pjesën tjetër, e thithte, sipas nevojës, nga vullnetarët, që i vinin prej feudeve të ndryshme të vendit, ndërkohë që edhe sistemi komandues pësoi ndryshime, të cilat atë e bënë më të suksesshme.<sup>773</sup>

Njëra ndër këto masa ishte ajo që filloi me zëvendësimin e kapedanëve që i vinin nga radhët e feudalëve të lëkundshëm me të rinj, që i nënshtroheshin fund e krye disiplinës ushtarake dhe komandës në përputhje me kërkesat e kryekomandantit, i cili në radhët e veta kishte edhe këshilltarë ushtarakë nga jashtë, të cilët i ndihmonin që ushtria e tij të ishte sa më e përgatitur për beteja. Në këtë drejtim ai shkeli imunitetin feudal, pastaj largoi aristokratët e pazotë apo të dyshimtë, të cilët jo vetëm që i zhveshi nga ofiqet, por bëri që zotërimet e feudalëve të dobët, si ato të Thopiave, Stresëve, Muzakëve, Gropave e të tjerëve, iu shkrinë ose u “aneksuan”, në principatën arbërore të Skënderbeut.<sup>774</sup>

Si rrjedhim, kufijtë e mëparshëm të zotërimeve feudale u kthyen dalëngadalë në kufij administrativë, kurse vetë zotërimet e veçura u shkrinë kohë pas kohe në një të vetme shtetërore. Ky proces shpuri në krijimin e shtetit të bashkuar arbëror.<sup>775</sup>

Shpronësimi i feudalëve dhe aristokratëve, shpesh edhe i dhunshëm dhe punësimi i shtresës ushtarake besnike ndaj Kryekomandantit, e cila mori në tërësi barrën e drejtimit të luftës së suksesshme, ishte e natyrshme të shkaktonte pakënaqësinë e bujarëve, të cilët kërkonin të ruanin pushtetin e tyre, i cili ishte mbështetur mbi të drejtën e feudit, pa marrë parasysh si zgjerohej ai. Kjo për rrjedhojë pati largimin e disa nga feudalët nga Lidhja Shqiptare e Lezhës dhe afrimin e tyre me Venedikun, Napolin, pa ngurruar kështu, që ndonjëri prej tyre të kalojë në anën e Osmanëve. Kundruall këtyre rrethanave, kur Skënderbeu ishte kthyer në një autoritet të pakontestueshëm dhe thujse që të gjitha punët i kishte

---

<sup>773</sup> Më gjerësisht shih: Fallmerayer, Ph: “*Das Albanesische Element in Griechenland*”, München, 1860, faqe 9; Jovius, P: “*Sub effigie Georgii Castrioti Scanderbeschi*”, në “*Elogia virorum*”, Basileu, 1561; Franco, D: “*Commentario dell cose de Turchi et del s: Geogio Scanderbeg, principe di Epyrro*”, Venetia, 1539. Gegaj, Athanas: “*L’Albani et L’Invasions Turque au XV siecle*”, Paris, 1937.

<sup>774</sup> Më gjerësisht shih: Muzaka, Gjon: “*Historia e Genealogjia e Shpis së Muzakajve e shkruie prej zotni Gjon Muzakës, Princ i Epirit*”, në revistën “Leka”, Shkodër, 1932. Pos të tjerash thuhet: “*Skënderbeu pasi u bë Komandant i zotërve të Shqipërisë... vendosi të shinte në dorë të gjithë vendin; ai futi në burg zotërinjt Gjon dhe Gjin Balsha (nipër të tij nga e motra, Jella) dhe ua mori shtetin e tyre që ishte midis Krujës dhe Lezhës.. zotit Mosi Komnenit i mori shtetin që e kishte në Dibër... Dhe pasi vdiq im atë, na mori neve Tomoricën, domethënë Myzeqenë e Vogël, dhe po ashtu ua mori edhe zotërve të tjerë, vendin e Komnenit dhe të Rancis, por ata s’kishin se ç’ të bënin, sepse ai kishte në dorë ushtrinë dhe ata kishin në çdo orë Turkun mbi krye...*”

<sup>775</sup> Frasherri, Kristo: “*Gjergj Kastrioti Skënderbeu – jeta dhe vepra*”, Tiranë, 2002, faqe 179.

marrë në dorë, Lidhja Shqiptare e Lezhës pothuajse e humbi krejt kuptimin e vet. Vendin e saj e zuri *Shteti i Arbrit*, i cili erdhi duke u rritur dhe duke u forcuar deri sa mori përherë e më tepër karakterin e një shteti të përqendruar.<sup>776</sup>

Por, cilat ishin përmasat e njëmendta të shtetit të Skënderbeut? Dhe, sa njëhej e sa pranohej ai nga jashtë? Bashkë me këtë shkon edhe çështja e identifikimit të tij me Skënderbeun ose të Skënderbeut me të. Diferencimi i kësaj çështje ka një rëndësi të madhe, meqë nxjerr në pah edhe qëndrimin që të tjerët kishin ndaj kësaj problematike dhe karakterin e luftës së Skënderbeut në raport me të.

Shteti i Skënderbeut, pra shteti i Arbrit, më 1451 shtrihej vetëm në një hapësirë që përfshinte krahinat e Shqipërisë së Mesme, të cilit, për t'u shtrirë më tej i rrinin zotërimet e Dukagjinëve dhe të Arianitëve, gjë që jo rastësisht ai do të quhet edhe mbret i Epirit dhe Maqedonisë. Dukagjinët, përkundër disa shenjave pajtuese (ato të Lekës), asnjëherë nuk u bënë pjesë e shtetit të Skënderbeut. Përkundrazi, ata bënë paqe me Sulltanin dhe, jo rrallë, edhe vepruan kundër Skënderbeut.<sup>777</sup>

Me Gjergj Arianitin, Skënderbeu pati një afrim të brishtë, pasi që në prill të vitit 1451 u martua me Donikën (Andronika), bijën e tij.<sup>778</sup> Por pas pak kohe Arianiti përsëri u shkëput, pasi që u lidh me Venedikun. Pas vdekjes së tij (1461) zotërimet iu shkrinë në shtetin e Skënderbeut.

Sipas të dhënave të shkëputura dhe nga burime të kohës, kufijtë e shtetit të Skënderbeut, në kulmin e lulëzimit të vet, shtriheshin në Perëndim, në brigjet e Adriatikut, që nga Velipoja deri në Seman (me përjashtim të qyteteve të Lezhës dhe Durrësit); në Lindje ato arrinin përtej Drinit të Zi, deri në malet e Korabit, Kërçinit e të Stagovës, së bashku me Grykën e Radikës; në Veri kufizoheshin me zotërimet e Dukagjinëve, afërsisht deri në kufijtë veriorë të krahinës së Matit; në Jug, përfshinin zotërimet e dikurshme të Arianitëve dhe të Muzakajve, pra diçka nga hapësirat e tri mbretërive antike, ajo e Maqedonisë, Epirit dhe Dardanisë, të cilat i simbolizonte jo vetëm përkrenarja e tij, por edhe vula, qoftë edhe si vizione politike. Në bregdet shteti i Skënderbeut kishte dy skela me mure të fortifikuara (kala). Njëra ishte skela e përmendur e Kepit të Rodanit (dikur Shufadaja) afër derdhjes së lumit Ishëm.

---

<sup>776</sup> Luarasi, A: "*Shteti dhe drejta shqiptare në shtetin e Skënderbeut*", Tiranë, 1998, faqe 130.

<sup>777</sup> Frashëri, Kristo: "*Skënderbeu – jeta dhe vepra*", Tiranë, 2002, faqe 180.

<sup>778</sup> Barleti e quan *Donika*, ndërsa Gjon Muzaka në Memorandën e tij e quan *Andronika* dhe shton se ishte vajza e parë e Gjergj Arianitit. Në dokumentet arkivore të vitit 1469 të kancelarisë aragoneze në Napoli, e shoqja e Skënderbeut quhet *Donika*, kurse në varrin e nipit të saj, peshkop Konstantinut që ndodhet në Napoli, ajo përmendet me emrin *Andronika (Andronica Cominata)*. Dhimitër Frëngu, i cili e ka njohur personalisht, e quan *Donika (quella bellissima et virtuisissima figliola di Arianit Comina che si chiamava Donica)*.



Këto pra, ishin pak a shumë, përmasat e shtetit të Arbrit gjatë kohës së Skënderbeut, emri i të cilit, megjithatë, do të marrë botën dhe do të mbetet referencë historike ndër më të qëndrueshmet që ka të bëjë me shtetin e Arbrit, që identifikohet me Skënderbeun dhe luftën e tij, një shtet që kishte tiparet e një monarkie feudale, pa monark, por me “zot”, që e udhëhoqi në mënyrë despotike.

Por, çfarë titulli kishte autori i tij?

Në historiografinë skënderbegiane ka një ngatërrim në lidhje me titullin e tij si kryetar shteti.<sup>779</sup>

Marin Barleti e quan Skënderbeun “Princ i Epirotëve” (*Epirotarum Princeps*).<sup>780</sup>Dhimitër Frangu më 1539 “Princ i Epirit” (*principe di Epyrro*). Frang Bardhi më 1636 “Princi i Epirotëve” (*Epirotaurum Princeps*). Duket se nën ndikimin e Barletit Skënderbeu është quajtur *Princ* edhe nga mjaft historianë të huaj.<sup>781</sup>

Si në aktet zyrtare evropiane drejtuar Skënderbeut dhe letrat që ka nënshkruar ai, nuk cilësohet as *princ*, as *mbret*, as *kryezot*, por thjesht “zot”. Pra, në aktet latinisht: *dominus*; në italisht: *sinor*; në spanjisht: *senypr*; në sllavisht: *gospodin*. Kështu, nga një letër që mori nga Alfonsi V, mbret i Napolit, më 14 dhjetor 1447, Skënderbeu quhej “zot i Krujës dhe krahinave të Arbërisë” (*Domine Croi provinciarum que Arbanie*).

Skënderbue, po ashtu, quhej edhe mbret i Epirit, Shqipërisë dhe i Maqedonisë. Për të Epiri dhe Maqedonia paraqisnin qendrën e mbretërisë mesjetare shqiptare me rrënjë në antikitet.<sup>782</sup>

Kjo ka rëndësi të veçantë, meqë identifikimi me këto mbretëri, ndër më të njohurat e antikitetit, sidomos me atë maqone të njohur si perandori botërore, plotësonte idenë për rikthimin e Arbërisë në një qendër të rëndësishme që do të bashkonte dy polet e qytetërimit perëndimor: lindjen dhe perëndimin, veçmas në

<sup>779</sup> Frashëri, Kristo: “Skënderbeu – jeta dhe vepra”, Tiranë, 2002, faqe 188.

<sup>780</sup> Barleti, Marin: “Historia e Skënderbeut”, Prishtinë, 1986, faqe 46.

<sup>781</sup> Më gjerësisht shih: P. Jovi (1551), F. Cumberti (1898). Disa e quajnë Skënderbeun “Mbret i Arbërisë” (*Roy d’Alanie*), si për shembull J. De Lavardin (1576) ose “Kin gof Albania” siç e quan Cl. C Moore (1850). Kjo mund të kishte ndikuar që edhe rilindësit tanë në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë Naim Frashëri mendonin se Skënderbeu kishte qenë “mbreti” i Shqipërisë, siç e cilëson në poemën kushtuar heroit (1899). Po ashtu Fan Noli, në punimin e tij të parë kushtuar Heroit më 1921, e quajti Skënderbeun “Mbret i Shqipërisë”, kurse në botimin e vitit 1950 e emërtoi thjesht “Kryezot i Arbërisë”. Sipas Kristo Frashërit, i cili përjashton që Skënderbeu të jetë quajtur “Kryezot”, ngase në shtetin e Skënderbeut nuk kishte bujarë vasalë, as para, as pas vitit 1450, mund ta kishte mbështetur nga një letër e Skënderbeut drejtuar princit Feranti G. A Orsjini, më 31 tetor 1460, ku ai flet për “vasalët e mi” (mili vasali), që në këtë rast ka kuptimin e funksionarëve vartës dhe jo të feudalëve të vegjël nën sovranitetin ose suzeranitetin e një sovrani.

<sup>782</sup> Shhi G. Raille, 1581: “Georgis Castriotis, is inqani a patre, Epiri que Albaniae, feu Macedoniae, princepe, datur obfēs Amurathi Turarum”

rrethanat kur tashmë hapësira e tyre ishte shkëputur dhunshëm nga osmanët dhe kërcënonte që t'i ndante përgjithmonë.

Edhe përkundër këtyre pretendimeve që kishte Skënderbeu rreth rolit të Arbërisë në rrethnat e reja dhe misionarizmit universal perëndimor të luftës së tij si mjet i vetëm për jetësimin e saj, që duhet të kihet parasysh dhe madje të trajtohen para të tjerave, aleatë e tij të parë dhe të natyrshëm, nuk dëshironin që Skënderbeun dhe kurorën e tij ta trajtonin me epitelin e mbretit të Epirit dhe të Maqedonisë. Madje, ndryshe nga Napoli, Republika e Venediku, në traktatin e paqes që nënshkroi me Skënderbeun më 4 tetor 1448, nuk i njohu atij *de jure* asnjë titull zyrtar, ndonëse *de facto* e trajtoi atë si përfaqësues të krerëve të Arbrit. Arsyet pse Venediku e bëri këtë janë të njohura. Republika e detit kishte marrëveshje të njohura me Perandorisë Osmane për zotërimin e bregdetit të Arbrit, të cilat, shtoheshin ose mëngoheshin në varësi të sukseseve të luftës së Skënderbeut në raport me Osmanët.

Por, edhe Skënderbeu do të sillet në përputhje me sukseset që korrite në fuqishat e luftës. Kështu, pas fitores në muret e Krujës mbi Muratin II, në vjeshtën e vitit 1450, ai e quan veten “Zot i Kujës” (*dominus Croie*), ose “Zot Arbëror” (*dominus albanensis*), ose (*sinor in Albania*) dhe jo “Zot në Arbëri” (*dominus Arbanie*). Në verën e vitit 1451, Skënderbeu na del me titullin zyrtar “Zot i Arbërisë” (*Dominus Albaniae*). Një muaj më vonë, duka i Milanit i drejtohet Skënderbeut me titullin e ri “Zot i Shqipërisë” (*dominus Albaniae*). Këtë titull zyrtar, Skënderbeu e përdori deri në fund të jetës së tij. Me këtë titull iu drejtuan, pas vitit 1451 pothuajse të gjitha kancelaritë e huaja. Madje, titulli “*dominus Albanie*” u fiksua, nëpërmjet inicialeve DA të vendosura në të dy anët e shqiponjës dykre-nore edhe në stemën heraklide.<sup>783</sup>

Kur jemi te vulat, krahas asaj shtetërore, me inicialet DA dhe shqiponjën dykrenore, e cila është kthyer në një emblemë me të cilën lidhet flamuri kombëtar dhe simbolet e tjera, aktet e veta financiare, Skënderbeu i pajiste me një vulë të posaçme, të cilën, për siguri, e mbante në formë unaze në dorë (*sigillumannulare*). Gjurmët e saj janë të depozituara në bankën e Raguzës. Ky lloj vule unazore kishte karakter sekret (*sigillum secretum*) dhe shërbente si një lloj kodi midis Skënderbeut dhe Bankës së Qytetit të Raguzës.<sup>784</sup>

Krahas qeverisjes së brendshme, udhëheqjes ushtarake si dhe financave, një faktor tjetër që ndikoi në konsolidimin e pushtetit shtetëror ishte trajtimi i të

<sup>783</sup> Frashëri, Kristo: “Skënderbeu – jeta dhe vepra”, Tiranë, 2002, faqe 191.

<sup>784</sup> Po aty.

gjithë banorëve dhe, lidhur me të, qëndrimi i barabartë ndaj dy riteve të krishtera që praktikoheshin në viset e Arbrit (katolikëve dhe ortodoksëve), me çka mund të tumirët vlerësimi se “feja u dha Arbërve unitetin që u mungonte në shtet, meqë ajo po ashtu shërbeu si një lidhje për t’i bashkuar me Perëndimin”.<sup>785</sup>

Në të vërtetë, lufta e suksesshme e Skënderbeut kundër Osmanëve, nuk do të ishte e suksesshme jashtë platformës ideologjike të bashkimit të dy kishave të krishtera, proklamuar në Koncilin e Firencës më 5 korrik 1439, kur u mor vendimi që kisha sërish të bënte përpjekje për të përballuar ndarjen e vitit 1054, kufiri i së cilës, drejtpërdrejt rëndonte mbi viset e Arbrit, duke krijuar një kufi lufte. Në Firencë, ku ishte i pranishëm vetë Papa Eugjen IV, Perandori i Bizantit, Joan VII Paleologu, së bashku me të vëllanë Dhimitrin, patriarkun e Kostandinopojës Josifin, peshkopin e Nikesë, Visarianin si dhe shumë klerikë dhe përfaqësues të tjerë, ishte folur shumë për këtë bashkim të kishave, i cili ishte shpallur solemnisht në kishën e katedrales së Firencës i hartuar njëherësh në latinisht dhe greqisht, por ujdia kishte të bënte më tepër me planet që të restaurohej Perandoria Romane me anën e parullës së dëbimit të “të pafeve” nga Evropa dhe deri nga ato pjesë që dikur i patën përkitur Perandorisë.<sup>786</sup>

Edhe pse dihet, se bashkimi i kishave nuk do të bëhet, ngaqë në Lindje, pra në Bizant, nga viti 1402, kishte fituar parulla e disfatistëve bizantinë: “*Më mirë Turku se Frengu!*”<sup>787</sup>, e cila i kishte rrënjët te sjellja e një pjese të klerit ortodoks, të cilët prej kohësh forcimin e pandalshëm të Perandorisë Osmane dhe depërtimin e islamit e shihnin një rast që t’i hakmerreshin katolicizmit, në mënyrë që të përfitonin, siç kishte ndodhur në të vërtetë, megjithatë, ishin Hungarezët e kërcënuar drejtpërdrejt nga pushtimet osmane, ata të cilët frymën e “bashkimit” të Koncilit të Firencës, do ta kuptojnë si një rast të mirë, që të bëjnë përpjekje për një luftë të përbashkët kundër Osmanëve.

Kishte madje optimistë, siç ishte Giovano Torzelo, funksionar i lartë bizantin me prejardhje italice dhe i lidhur me *italikët*, që llogariste edhe fuqinë e Arbërisë në këtë luftë si shumë të rëndësishme, meqë sipas tij kishte dy zotë që mund të ngrënë 20 mijë luftëtarë kalorës dhe që gjithashtu, sapo të shikonin të vinte një fuqi e krishterë, do të kthenin menjëherë kundër Turkut.<sup>788</sup>

---

<sup>785</sup> Noli, Fan S: “*Gjergj Kastrioti Skënderbeu*”, Tiranë, 1967, faqe 43.

<sup>786</sup> Më gjerësisht për këtë “bashkim” shih te Erhard: “*Geschichte des Wiederaufblühens*“, München, 1980.

<sup>787</sup> Noli, Fan S: “*Gjergj Kastrioti Skënderbeu*”, Tiranë, 1967, faqe 55.

<sup>788</sup> Plasari, Aurel: “*Skënderbeu*”, Tiranë, 2010, faqe 296.

Nëse mund të pranohet vlerësimi se “koncili i bashkimit”, ndoshta mund të kishte ndikuar te largimi i Skënderbeut nga detyra më 1440 (bëhet fjalë për postin e subashit që e mbante në Krujë pas vdekjes së të et, Gjon Kastriotit)<sup>789</sup>, me siguri se frymën e këtij “bashkimi” Skënderbeu do ta shfrytëzojë në mënyrën më të mirë të mundshme për nevojat e brendshme, pra që t’i heqë mundësitë e të gjitha ndasive, të cilat do të mund t’i ktheheshin në pengesa të mëvonshme. Madje, që të gjitha faktet flasin se Skënderbeu, koncilin e shfrytëzoi që t’i forcojë trendet e njohura që edhe kishat ortodokse të lidheshin me kishën e Romës pa i prerë lidhjet me Kostandinopojën, trendë këto që kishin filluar në çerekun e fundit të shekullit XIII, kur kishat ortodokse të viseve që u përfshinë në “Mbretërinë e Arbërisë” nga Rubiku deri në Himarë, të krijuara nga mbreti katolik frëng i Napolit, Karli I Anzhu, pa e ndryshuar ritin kishtar tradicional bizantin.

Edhe pse kjo gjendje nuk mund të shihet jashtë trysnisë së faktorit politik, siç ishte ai i ndikimit Anzhu dhe rrethanave kur vendet e Arbrit po kalonin nëpër një ndryshim të detyrueshëm, të cilët synonin të krijonin Perandorinë Latinë të Lindjes që u shemb në vitin 1260, megjithatë, nuk duhet lënë pas dore edhe faktorin arbëror - interesi madhor i Arbërve, të cilët po shqetësoheshin nga lakmitë për pushtim tokash drejt Adriatikut të feudalëve ortodoksë të Rashës dhe nga bindja e tyre se këtë rrezik mund ta përballonin vetëm me përkrahjen e Anuzhuve dhe jo të Bizantinëve ortodoksë të dobët dhe, aq më tepër, aleatë të Sllavëve.<sup>790</sup>

Kështu, një nga dioqezat e para ortodokse që u lidh me Romën ishte peshkopata e Krujës, e cila vepronte nëpërmjet Kryepeshkopatës ortodokse të Durrësit, nën varësinë e Patriarkatit të Kostandinopojës që kur ndeshet për herë të parë në Koncilin e Kostadinopolitas Fotian të vitit 879 deri kur përmendet për të fundit herë në listën e kishave lindore, në Taktikonin e Mihali Paleologut, më 1282.<sup>791</sup>

Ngjashëm do të ndodhë edhe me disa dioqeza të tjera ortodokse të mitropolisë së Durrësit, me ç’rast fshihen përfundimisht nga gjeografia kishtarë peshkopata ortodokse e Cërrikut, Kunavisë, Drishtit, Pultit, Shkodrës dhe e Tivarit, ose që disa prej tyre e kthejnë fytyrën nga Roma dhe lidhen me Selinë e Shenjtë (peshkopata e Stefaniakës në Dibrën e Poshtme *episcopus Stephaniensis*, Peshko-

---

<sup>789</sup> Inalxhik, Halil: “*Iskender Beg*”, në “*Enciklopedie de L’Islam*”, nouv, ed. Etc, vëll. II, Leyden, Paris, 1961.

<sup>790</sup> Frashëri, Kristo: “Skënderbeu”, Tiranë, 2002, faqe 185.

<sup>791</sup> Më gjerësisht shih: “*Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetis Illustratia*”, vol I, Vjenë, 1913, dok, nr, 57; Farlati, D: “*Illyricum Sacrum*”m vol. VII, Venetis, 1817, faqe 414.

pata e Lisit në krahinën e Matit, Peshkopata e Pulheriopolit, e ajo e Vlorës, e cila zuri vendin e Peshkopatës së Apolonisë).<sup>792</sup>

Fenomeni i shkëputjes së lidhjeve me Kostandinopojën dhe me Selinë e Shenjtë u shtri në pjesën më të madhe të vendeve të Arbrit dhe kjo mund të shpjegohet sa me rritjen e rrezikut të pushtimit sllav, sidomos pas pushtimeve të Stefan Dushanit në gjysmën e parë të shekullit XIV, e sa me rënien e Perandorisë Bizantine, sundimi i së cilës në Arbëri mori fund në mes të të njëjtit shekull, me ç'rast Arbërve ua krijuan bindjen dhe i bënë të shpresonin se shpëtimi i tyre mund të vinte vetëm nga Perëndimi.<sup>793</sup>

Sipas Farlatit, shikimi arbëror kah krishterimi perëndimor shpjegohet edhe me të dhënë se në shekullin XV gjeografia kishtare në Arbëri ishte në dobi të kishes katolike romane me tetëmbëdhjetë seli peshkopate, disa prej të cilave me një histori të pandërprerë që prej agimit të Krishterimit.<sup>794</sup>

Lufta e Skënderbeut duhet t'i ketë forcuar edhe më tepër këto prirjeje, madje deri në atë masë, saqë “çdo peshkop ishte mbledhës fondesh për kryqëzatën e Skënderbeut; çdo kallogjer ishte një agjent propagandistik i tij”.<sup>795</sup>

Kjo mund ta ketë shtyrë Nolin të vlerësojë se “feja u dha Shqiptarëve unitetin që u mungonte si shtet”, gjë që sipas tij, “feja ka shërbyer po ashtu edhe si një lidhje për t'i bashkuar me Perëndimin”.<sup>796</sup>

Si rrjedhim, kur Skënderbeu shpalosi flamurin e luftës çlirimtare, gjeografia kishtare e Arbërisë, paraqitej me tri ngjyra: në viset veriore dhe verilindore mbisundonte kisha katolike, e lidhur nga pikëpamja kanonike, rituale, organizative dhe politike me Romën; në krahinat qendrore jugore dhe juglindore vazhdonte të sundonte kisha ortodokse, e cila edhe pse e drobitur nga pushtimi osman i ruante në parim lidhjet kanonike, rituale, organizative dhe politike me Patriarkatin e Kostandinopojës dhe shfaqej si shumicë; ndërsa në viset midis tyre, mbisundonin kishat e quajtura më vonë *unite*, të cilat respektonin ritin dhe liturgjinë tradicionale bizantine, kurse nga pikëpamja organizative dhe politike qenë lidhur me Selinë e Shenjtë Romane.

Pavarësisht nga preferencat që pati për Selinë e Shenjtë Romane, Skënderbeu qëndroi dhe veproi mbi këto ngjyra.<sup>797</sup>

---

<sup>792</sup> Po aty.

<sup>793</sup> Frashëri, Kristo: “*Skënderbeu*”, Tiranë, 2002, faqe 186.

<sup>794</sup> Farlati: “*Illyrici sacri*”, Vëll, VII, f.IX-XIV; Jireček, K: “*Handelsstrassen und Bergwerke von Serbien und Bosnien wehrend des Mittelalters*”, Prag 1879, faqe 16.

<sup>795</sup> Shih Theiner: “*Monumenta Slavorum*”, vëll. I. Nr. DOVI, f 427-8.

<sup>796</sup> Noli, Fan Stilian: “*Gjergj Kastrioti Skënderbeu*”, Tiranë 1967, faqe 43.

Kjo, madje, mund të vërtetohet më së miri me faktin se në radhët e veta ai pati bashkëpunëtorë të vet, komandantë ushtarakë nga tri ngjyrat kishtare – kapedanë si Tanush Thopia (i kishës katolike të Durrësit), Zakaria Gropa (i kishës ortodokse të Ohrit), Kuka (i kishës *uniatë* të Stefaniakës). Po ashtu, ai ngarkoi me misione diplomatike, jo vetëm prelatë të ritit katolik, si Engjëllin, por edhe prelatë të ritit lindor si peshkopin e Krujës, Stefanin.<sup>798</sup>

Qëndrimi i njëjtë që mbante Skënderbeu ndaj dy kishave të krishtera shihet edhe nga një shkrim hagiografik mbi jetën dhe veprimtarinë e Nifonit - arvanitas nga Morea, i cili u bë patrik i Kostandinopojës në dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit XV, me ç'rast bëhet e ditur se para se të kurorëzohej patrik i Kishës Lindore, bashkë me Zakarinë kishte udhëtuar për në Krujë, ku ishte takuar me Skënderbeun dhe aty ai ishte bindur për respektin e madh që tregonte ai edhe për kishën lindore.<sup>799</sup>

## SKËNDERBEU DHE PERËNDIMI

Skënderbeu, sapo të bashkojë feudalët e Arbrit dhe sukseset e luftës të ndikojnë që ky bashkim të kthehet në një shkrirje të brendshme, do t'u kthehet përpjekjeve që forcimi dhe mbështetja e shtetit të Arbnit mbi bazat e një bashkimi feudal, të lidhet edhe me ndihmën që atij do t'i vijë nga Perëndimi, në radhë të parë, nga aleatët e mundshëm përtej Adriatikut dhe Vatikanit, me çka, dashur a pa dashur, lufta e suksesshme me Osmanët, do ta kthejë në mbrojtës të Perëndimit dhe të krishterimit në përgjithësi. Ky relacion i ri, lidhej me strategjinë e përbashkët të Perëndimit, sipas një vendimi të arritur në Koncilin e “bashkimit” të Firencës rreth një fushatë të krishterë, ku sipas të gjitha gjasave, Skënderbeu dhe Arbëria do të luanin një rol të rëndësishëm.

Kjo pozitë dhe ky rol, që dilte si fryt i rrethanave, Skënderbeut nuk do t'ia ndryshojë as sjelljen e as qëndrimin që kishte se luftën duhej ta bënte vetë dhe me të gjitha forcat, ndërkohë që nga jashtë ajo do të ndihmohej me të gjitha mjetet, dhe se ndihma më e madhe do të ishte po qe se vendet e krishtera, secila veç e veç, por edhe të bashkuara, do të hynin në luftë me Osmanët, qoftë në vijën

---

<sup>797</sup> Po aty, faqe 187.

<sup>798</sup> Po aty.

<sup>799</sup> Më gjerësisht shih: Beduli, DH: “Disa të dhëna lidhur me periudhën e Skënderbeut nga një vepër hagiografike e shekullit XVI”, në “Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike”, vëll. I, Tiranë, 1969, faqe 629.

e parë të fronteve, ku ato tashmë shfaqeshin, qoftë edhe me shpalljen e luftës së përbashkët Osmanëve nga të gjitha vendet e krishtera, pa marrë parasysh largësitë dhe gjendjen fizike me ta në mënyrë që ajo të përgjithësohej.

Në këtë gjendje, ashtu si vepronte, pra e kthyer në një fushëbetejë të përhershme ku Osmanët pësonin disfata, pse nuk ia dilnin që të thyenin rezistencën e Arbërve duke ua marrë kështjellat dhe hapësirën prej nga vepronin, Arbëria e Skënderbeut shfaqej si emërues i përbashkët i një lufte të Perëndimit kundër Osmanëve në një front, që do të ishte i mundshëm nëse do të mbështetej mbi interesat po ashtu të përbashkëta të bërrjes jashtë përvojës së deriatëhershme, të shumtën e karakterizuar në njërin anë me vija frontesh të shkëputura (Lufta e Maricës në vitin 1371, Lufta e Fushë-Dardanisë në vitin 1389 dhe lufta e dytë e Dardanisë në vitin 1448, rëndom të bëra nga popujt e Ilirikut dhe ata të Europës Qendrore), dhe në tjetrën anë, me sehir të të tjerëve, ose me lidhje të marrëveshjeve të veçanta me Osmanët, siç ishin ato të venedikasve, të cilat u kanë shkuar në dobi Osmanëve dhe në dëm atyre që janë përfshirë në vijën e luftës me ta.

Skënderbeu këtu do të fillojë të shohë dhe të kuptojë praktikisht shpërputhjen midis asaj që për Perëndimin dhe me të edhe për krishterimin paraqet interes të përbashkët dhe sjelljes së njëmendët në mbrojtje të tij, kur do të dalin në pah interesat e veçanta, të cilat do të vihen mbi ato të përbashkëta, ku lufta e Arbërve do të shfaqet e mirëseardhur, por që të mbetet dhe të përqendrohet në hapësirën e tyre sa më gjatë që të jetë e mundur duke ngujuar osmanët aty me çka ata frenoheshin në një cep të saj. Ndërkohë që prapa lustrës së përkrahjes së saj, lavdisë dhe ndonjë ndihme me mjete që do të bëhej me shumë zhurmë, do të bëheshin bisedime të fshehta me Osmanët dhe madje edhe marrëveshje, siç do të jenë ato të Venedikut, të cilat në disa raste, do të anashkalojnë fare interesat strategjike të Perëndimit si tërësi, ku kundërvënja atyre paraqiste atë të rrosh apo mos të rrosh. Këtu, madje duhet parë edhe arsyet e njëmendta të dështimit të asaj që nga papa Piu II ishte paraparë si kryqëzatë e krishterimit kundër Osmanëve, e cila duhej të udhëhiqej nga Skënderbeu. Vdekja e papës Piu II, kur po bëheshin përgatitjet e fundit dhe Skënderbeu anuloi edhe një marrëveshje paqësore që kishte bërë me Sulltanin, mund të kishte pasur ndikim që ajo të mos fillonte në kohën e caktuar, por assesi që të mos bëhej fare. Sepse, koha do të tregojë se Perëndimi as që ishte i gatshëm për diçka të tillë, meqë luftën e përbashkët pos me fjalë, jo vetëm nuk e bënte, por as që e donte, nga shkaku se gjithnjë e më shumë përdorte marrëveshjet e fshehta me Osmanët.

Vizionit të Skënderbeut për një shtet të fuqishëm feudal të Arbrit në hapësirën e vet etnike, i cili po qe se do të mund të dëshmohej në luftë kundër Osmanëve, do të mund të paraqiste një bazë të mirë për rimëkëmbjen e Perandorisë së Romës së paku në pjesën europiane, krahas hezitimeve të vendeve të krishtera përtej Adriatikut që të pranonin rolin e tij si prijës të kryqëzatës i cili do të udhëhiqte Perëndimin kundër Osmanëve, grushtin më të madh do t'i japin fqinjët e tyre, në radhë të parë Sllavët dhe Helenët. Këta të parët, jo vetëm që nuk do të përfshihen në luftën e Arbërve kundër Osmanëve, por do të bëjnë çmos që ajo të mos fitonte përmasat e vijës së parë të ndeshjes me Osmanët, siç i kishte paraparë Skënderbeu me anën e Luftës së dytë të Dardanisë të vitit 1448,<sup>800</sup> ku krahas të Hungarezëve, Kroatëve, Polakëve do të duhej të merrnin pjesë edhe Rasianët, Arbrit dhe Helenët-bizantinë. Ajo do paraqiste një rast të mirë për një shpagim të përbashkët ndaj humbjes në luftën e parë të vitit 1389.

Të dhënat e shumta tregojnë se kjo luftë do të jetë humbur para se të kishte filluar si duhej, kur princi Gjuragj Brankoviq, i njohur për vasalitetet dhe aleancat me Bajazitin, (me Mehmetin I dhe Muratin II), jo vetëm që nuk do të përfshihej në të, sipas marrëveshjes paraprake me Huniadin dhe Skënderbeun, por me një dredhi të madhe, së pari do të pengojë depërtimet e Huniadit drejt Dardanisë, të cilat duhej bërë nëpër zotimet e tij dhe pastaj, sipas një marrëveshje të fshehtë me Osmanët,<sup>801</sup> disa nga njësitë e veta do t'i fusë në luftë kundër Hungarezëve edhe para kohës së caktuar për betejë, që ishte bërë sipas marrëveshjes të fillojë më 19 tetor të vitit 1448 në Dardani.

Thika që Huniadit do t'i vijë nga tradhtia e Brankoviqit para se forca e tij kryesore ushtarake të arrijnë në Dardani, lidhet edhe me një faktor tjetër – Venedikun, i cili, në forma të ndryshme ishte përfshirë në dredhitë dhe lojërat sllavo-osmane kundër Skënderbeut dhe aleancës së krishtere kundër Osmanëve. Sipas burimeve të njohura, merret vesh se sapo Skënderbeu dhe Huniadi, në bashkëpunim me Brankoviqin, do të caktojnë kohën e betejës së dytë të Dardanisë (nga mesi i tetorit), venedikasit do të fillojnë veprimet luftarake në veriperëndim të Arbërisë për t'i rikthyer disa nga tokat që Skënderbeu i kishte marrë prej tyre me anën e luftës.

Venediku, nga druajtja se do t'i humbte edhe zotërimet e tjera që mbante në bregdetin shqiptar, kishte pranuar humbjen e tyre me kusht që ai të mos shkonte

---

<sup>800</sup> Shih Malkom, Noel: *“Kosova, një histori e shkurtër”*, Prishtinë, 2001.

<sup>801</sup> Po aty.



më tutje. Madje Venediku, sipas një marrëveshje me Skënderbeun, kishte pranuar që atij t'i jepej edhe një tribut prej 1400 dukatesh në vit.<sup>802</sup>

Marrja e papritur me venedikasin, Skënderbeut ia theu rrugën për në Dardani për disa ditë, kështu që, njësitë kryesore për atje, të cilave u priu vetë, i nisi më katër tetor, pra me një vonesë prej tri javësh, vonesë kjo që do të jetë e kobshme për fatet e luftës me Osmanët në Dardani, ngaqë do të bëhet e ditur se sapo Skënderbeu, nga dy drejtime do t'i afrohet Fushës së Dardanisë (nga Prizreni dhe nga Shkupi), ndeshi pjesë të ushtrisë së Huniadit të thyera në ikje e sipër. Aty e mësoi të vërtetën e hidhur dhe me të shpejtë kthehet në Krujë, ngaqë e kishte më se të qartë se humbja e asaj beteje paraqiste më shumë se aq: humbjen e shpresës për frontin e përbashkët të vijës së parë të ndeshjes me Osmanët midis Arbërorëve, Rasianëve dhe Hungarezëve, të ndihmuar nga Bullgarët, helenët-bizantinë dhe Vllahët, ku do të përfshiheshin edhe Kroatët dhe Boshnjakët, të cilëve pastaj do t'u vinin në ndihmën vendimtare Gjermanët, Polakët, Francezët dhe principatat dhe mbretëritë e tjera italiane dhe ato spanjolle, në atë që do të paraqiste kryqëzatë krishtere kundër Osmanëve, pikërisht si do ta ketë paraparë edhe Papa Piu.<sup>803</sup>

Nga disa “të dhëna” të pakonfirmuara del se Skënderbeu, para se të kthehej ndëshkoi Gjurgj Brankoviçin në afërsi të Krushecit, prej nga pastaj nga drejtimi i Shkupit mori masat që barra e vijës së parë të ndeshjeve me Osmanët, të rrudhej gjithandej nga shtriheshin tokat e vendeve të Arbrit, të cilat ai tashmë i kishte bashkuar dhe i nënshtroheshin një drejtimi të përbashkët. Humbja e kësaj lufte dhe ndërlikohja e prapaskenave midis despotëve vasalë të sulltanit dhe venedikasve do t'ia bëjnë me dije se kishin qenë iluzore si lidhjet e familjes së tij me princat e Rashës (me origjinë tribale me rrënjën e përbashkët ilire-dardane, ose që ishin Ilirë të sllavizuar, krejt një) dhe ato me kishën sllavo-ortodokse rreth asaj se përballë rrezikut osman, ato duhej t'u shërbejnë interesave të përbashkëta, siç kishin qenë iluzore edhe premtimet e Venedikut rreth aleancave të përbashkëta të Perëndimit kundër Lindjes (Osmanëve), që do të ktheheshin në një kryqëzatë të shenjtë, të cilave Republika e Shën Markut, jo vetëm që nuk do t'u bashkohej, por edhe do t'u vë ndërkëmbëse të vazhdueshme.<sup>804</sup>

Në të vërtetë, raportet e Skënderbeut me venedikasin, përkundër disa marrëveshjeve si dhe ndihmave të herë pas hershme që ka marrë nga senjoria, asnjëherë

---

<sup>802</sup> Po aty.

<sup>803</sup> Shih: Plasari, Aurel: “Skënderbeu”, Tiranë, 2010, faqe 385-414.

<sup>804</sup> Po aty.

nuk kanë qenë miqësore e as të sinqerta, ngaqë për venedikasit Skënderbeu ka shfaqur përherë shqetësimin qoftë kur arrinte suksese – meqë ato preknin interesat e saj në viset arbërore ku ajo mbante shumë pjesë, ose kur ishte i detyruar të lidhte marrëveshje paqeje me Osmanët, meqë ato mund të dobësonin pozicionin e tyre në këtë pjesë, që ajo e konsideronte si shumë të rëndësishme për interesat e saj ekonomike, por edhe politike edhe në raport me Perandorinë Osmane.

Këto raporte, zunë të kthehen në mosbesuese për të mbetur të tilla deri në fund, kur Skënderbeu ia doli të mbledh Lidhjen e Lezhës, të quajtur si Lidhje Shqiptare të parën e llojit të tillë mbi të cilën u bë përpjekje që të vendosej uniteti i brendshëm feudal në luftë kundër Osmanëve, por edhe për bashkimin e trojeve të copëtuara shumë prej të cilave (disa nga qytetet bregdetare) gjendeshin në zotimet venedikase. Siç pritej Venediku, jo vetëm që nuk e njohu këtë Lidhje historike të feudalëve arbërorë, por u mundua që atë ta zhvlerësojë në të gjitha mënyrat. Në disa nga aktet që nxori Senati (kryesisht raporte me Skënderbeun në rrethanat e reja), ai cilësohej jo si Kryetar i Lidhjes Shqiptare, por si “një ndër zotërinjtë e këtyre viseve” (*diti domini Jeorgia et aliorum dominorum circumtantiam*), me çka për Venedikun ai ishte vetëm si zot i dy krahinave malore, larg zotërimeve të saj në Adriatik.<sup>805</sup>

Natyrisht se Venediku dëshironte që Skënderbeun ta shihte të shkëputur nga fuqia dhe ndikimi i brendshëm që ai tashmë e kishte arritur me Kuvendin e Lezhës, ngaqë u pa se ai donte të krijonte nga një grusht zotërinjsh të vegjël arbërorë (shumë prej të cilëve deri atëherë ishin kush më shumë e kush më pak në pozitën e klientelës ndaj Republikës) një organizim shtetëror, gjë që fuqizimi i mëtejshëm i pushtetit të Skënderbeut nënkuptonte edhe përfshirjen e qyteteve bregdetare shqiptare që ndodheshin në zotërimin e tij.<sup>806</sup>

Edhe pse nga disa burime mund të kuptohet se Skënderbeu nuk e dëshironte një konflikt me Venedikun, veçmas në rrethanat kur ai kishte përballë ushtritë osmane që po vërshonin nga të katër anët të vendosura t’i jepnin fund asaj që ata e quanin kryeneçësi kundër sulltanit, megjithatë ai ishte i pashmangshëm, ngaqë shkas për konfliktin u bë qyteti i Danjës,<sup>807</sup> që u provokua nga venedikasit, të cilët shfrytëzuan një hasmëri midis familjeve të njohura Zaharisë, zot i Danjës dhe Lekë Dukagjinit, zot në të dy Pultet, që sipas një varianti të zmadhuar dhe

<sup>805</sup> Frashëri, Kristo “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, Tiranë 2002, faqe 145.

<sup>806</sup> Më gjerësisht shih te Bartl, P: “Relazioni fra Scanderbeg e Venezia”, në “V Convegno Internazionale di Studi Albanesi – V, Mbledhja Ndërkombëtare Studimesh Shqiptare”, 1968, Atti/Akte, Palermo 1969, faqe 162-163.

<sup>807</sup> Shih Frashëri, Kristo: “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, Tiranë 2002, faqe 146.

me shumë fantazi të priftit italian G. Biemmit “si një konflikt dashurie me intriga u kthye në një tragjedi të madhe”.<sup>808</sup>

Ky vlerësim, pak a shumë, pranohet edhe nga F. Noli.<sup>809</sup> Por, anashkalohet fare nga M. Barleti, i cili gjithë çështjen e rrudh te kundërshtimi i banorëve të Danjës që kundër synimit të Lekë Dukagjinit ta merrte Danjën, gjë që kjo bëri që nëna plakë e Lekë Zaharisë së vvarë nga Dukagjinët, e cila nuk kishte trashëgimtarë, zotërimin e të birit t’ua dorëzojë venedikasve të Shkodrës, me çka sipas Barletit, Venedikasit morën përsipër përgjegjësinë e rëndë të luftës kundër princërve arbërorë.<sup>810</sup>

Ishte e pritshme që rënia e Danjës në duart e venedikasve të përjetohej si një humbje për Lekë Dukagjinin, por edhe për Lidhjen Shqiptare dhe Skënderbeun, i cili sipas Barletit, “u tërbua, ngaqë pushtimi i saj ishte një pykë që vështirësonte bashkimin e viseve veriore me shtetin shqiptar”.<sup>811</sup> Sepse, sipas Barletit, midis Skënderbeut dhe Lekë Zaharisë, që nuk kishte trashëgimtar, kishte ekzistuar një marrëveshje, që si thuhet “kush të vdesë i pari pa fëmijë, t’i lërë tjetrit që do të mbetej gjallë mbretërinë për ta pasur në bazë të së drejtës së marrëveshjes”.<sup>812</sup>

Në këto rrethana, krahas Venedikut, si shkelës i marrëveshjes, shfaqet edhe Lekë Dukagjini, i cili për vite të tëra u distancua nga Skënderbeu, ngaqë ai gati sa nuk hyri në luftë me të për këtë çështje, që mbase këtë edhe do ta bënte po mos të ishte se kishte për bashkëluftuar të vëllanë Nikollë Dukagjinin, i cili, po ashtu kërkonte që ta shtinte në dorë për vete kështjellën e Danjës.<sup>813</sup>

Duke i pasur parasysh rrethanat e brendshme, pra interesat e Dukagjinëve dhe ato të jashtme, të cilat ishin te një natyre strategjike, Skënderbeu nuk u ngut. Kjo nxori në pah sensin e tij të njohur politik dhe diplomatik karshi rrethanave të tilla tepër të rëndësishme. Kështu që, çastin që të futej në luftë me Venedikun, e hetoi në vjeshtën e vitit 1477. Me këtë rast thirri mbledhjen e Lidhjes Shqiptare. Nga aty kërkoi që të dalë vendimi për shpalljen e luftës Venedikut nëse nuk do t’ia kthente Lidhjes qytetin e Danjës.

Ndonëse ky vendim u kundërshtua nga anëtarë (Pjetër Spani dhe Gjergj Dushmani - zotërit e Pultit të Epërm), të cilët me këtë rast edhe u larguan nga

---

<sup>808</sup> Shih Giammaria, Biemmi: “*Istoria di Giorgio Castrioto Skander-begh*”, Brescia, 1742.

<sup>809</sup> Shin Noli, Fan S: “*Gjergj Kastrioti Skënderbeu*”, Tiranë 1957, faqe 91.

<sup>810</sup> Barleti, Marin: “*Historia e jetës dhe veprës së Skënderbeut*”, Prishtinë 1968.

<sup>811</sup> Më gjerësisht rreth qëndrimeve të Barletit shih “te K, Frashëri “*Gjergj Kastrioti Skënderbeu*”, Tiranë 2002, faqe 148.

<sup>812</sup> Po aty.

<sup>813</sup> Po aty.

“Lidhja Shqiptare”, megjithatë, ai për herë të parë, bëri një demonstrim të suksesshëm nga brenda dhe për jashtë, me ç’rast tregoi se Lidhja, nuk mund të pajtohej që me pushtimin më parë të Drishtit dhe më pas të Danjës, Venediku të shtinte në dorë dy ”çelësat” që kontrollojnë rrugën e dy Pulteve (Dukagjinit) dhe të malësive të tjera verilindore.<sup>814</sup>

Por, lufta me Venedikun rreth Danjës, për Skënderbeun nuk ishte vetëm një matje e rëndësishme që të siguronte tërësinë e shtetit të sapoformuar nga “Lidhja e Lezhës”. Përkundrazi, ajo shfaqej edhe si një hesap i jashtëm që si i tillë mund të fuste në lojë shumë faktorë në dobi të tij, meqë Venediku tashmë ishte në një konflikt me Dukatin e Lombardisë. Kjo e shtyri edhe Papatin të ndërhynte, në mënyrë që të mos dobësohej lufta antiosmane e Shqiptarëve e cila ishte në vllug, ndërkohë që as fryma e saj në Perëndim të mos fashitej me një luftë midis Shqiptarëve dhe venedikasve. Kështu, për të shmangur çfarëdo përçarje, Papati përgëzoi Skënderbeun për luftën me sukses që po zhvillonte kundër Osmanëve si “atlet tepër i fuqishëm” (*fortissimo atleta*) në mbrojtje të fesë së krishterë dhe “goditës sypatrembur” (*intrepidopugile*) në mbrojtje të nderit, të rritjes dhe të stabilitetit të fesë së krishterë në qytetet dhe katundet e Shqipërisë. Ndërsa, në tjetrën anë, nga Venediku, në raport me Skënderbeun dhe kërkesat e tij, kërkonte sjellje të duhur, ngaqë, lufta e tij kundër Osmanëve, ishin të lidhura me interesat madhore të Perëndimit. Por, si do të shihet, çështja madhore e interesave të perëndimit, të cilat lidheshin me luftën e Skënderbeut kundër osmanëve, nga Venediku shiheshin ndryshe, pra në përputhje me interesat e Republikës së Shën Markut në breg-detin shqiptar. Kjo kishte bërë që Venediku të hynte në aleanca të fshehta me Osmanët. Sipas kësaj marrëveshje, Osmanët kundër Skënderbeut, në krahun e Dibrës, duhej të hidhnin një ushtri, që do të shpërqendronte luftën me Venedikun, që zhvillohej në veri, në Drin. Sipas burimeve të kohës në betejën vendimtare që u zhvillua në korrik të vitit 1448 luftëtarët e Skënderbeut mundën ushtrinë venedikase të komanduar nga Daniel Gjurici.<sup>815</sup>

Fitorja e Skënderbeut mbi venedikasit vërtetohet edhe nga traktati i paqes që u nënshkruar midis tyre më 4 tetor 1448. Paraprakisht kjo fitore si dhe marrëveshje me venedikasit, për Skënderbeu pati një çmim të hidhur, meqë ajo kaloi nëpër një disfatë, të parën në luftë kundër Osmanëve, atë të humbjes së Sfeti-

---

<sup>814</sup> Po aty, faqe 150.

<sup>815</sup> Rreth fitores së Skënderbeut kundër venedikasve në verën e vitit 1448 shih Barleti, M: “Skënderbeu”, Prishtinë, 1968 si dhe Biemmi, G. “Istoria di Giorgio Castrioto Scander-begh”, Brescia 1742; Noli, Fan S: “Gjergj Kastrioti Skenderbeu”, Tiranë 1967, faqe 89.

gradit, e cila vlerësohet se paraqiste një sakrificë për t'u shpëtuar Kruja, e cila u bëri ballë sulmeve të fuqishme osmane të drejtuara nga Murati II.<sup>816</sup>

Humbja e Sfetigradit, por mbrojtja e Krujës dhe marrëveshja e paqes me Venedikun e tetorit të vitit 1448, Skënderbeun e faktorizuan edhe më në sytë e Papatit, që tashmë e shihte si “engjëll shpëtimtarë” dhe në sytë e Venedikut, që ndonëse ia dolën që disfatën me ushtrinë e tij në Drin, me rikthimin e Danjës dhe pjesëve të tjera përtej lumit Drin, ta kthejnë në një fitore diplomatike, ishin të vetëdijshëm se rezistenca e tij mund t'u shkonte për shtati që të mbanin të hapura edhe prapaskenat me Osmanët, kështu që kjo nuk i ndali nga loja e tyre e dyfishtë, ku nuk mungonin prapaskenat e ndryshme.

Përkundër këtyre prapaskenave, disa prej të cilave mbase edhe mund t'i kishte paraparë, sepse i njihte raportet e tilla, megjithatë, mund të thuhet se Skënderbeu nuk ka qenë kurdoherë i vetëm në luftën e tij epike, ngaqë në mënyra të ndryshme, ka qenë i përkrahur edhe nga faktorë të fuqishëm, të tillë si Papati, Mbretëria e Napolit, Qyteti i Raguzës, e madje në disa momente edhe nga Republika e Venedikut,<sup>817</sup> përkundër faktit se me Venedikun kishte telashe të mëdha, ngaqë mbikëqyrte qytetet kryesore të Adriatikut (Durrësin, Lezhën, Dri-shtin, Ulqinin, Tivarin dhe Shkodrën) dhe pjesë të tjera në Veri, ku e ka burimin edhe sintagma “*Arbëri Veneciane*”.<sup>818</sup>

Meqë Arbëria ishte ura e fundit katolike-romane në Ilirik dhe papët bënin çmos për ta ruajtur dhe për ta zgjeruar, ishte e qartë se ajo duhej të ndihmohej me të holla dhe me njerëz (ushtarakë). Tek e fundit mbështetjen e çfarëdo rezistence kundër Osmanëve, si prioritet të Perëndimit, e kishte formuluar edhe Koncili i Firencës i vitit 1448-1449. Edhe pse Foigti dhe Falmerajeri thonë se papët i ndihmuan Skënderbeut vetëm me bekime apostolike dhe me ligjërata panagjerike,<sup>819</sup> megjithatë, ka dokumente që provojnë se papët Nikolla V (1447-1453), Kaliksti III (1453-58), Piu II (1458-1473) i ndihmuan Skënderbeut me të holla

---

<sup>816</sup> Rreth disfatës së Sfetigradit dhe paqes me Venedikun shih. Noli, Fan S: “*Gjergj Kastrioti Skënderbeu*”, Tiranë 1956, faqe 93; Frashëri, Kristo “*Skënderbeu*”, Tiranë 2002, faqe 158; Plasari, Aurel: “*Skënderbeu*”, Tiranë 2010

<sup>817</sup> Noli, Fan S: “*Gjergj Kastrioti Skënderbeu*”, Tiranë, 1967, faqe 37

<sup>818</sup> Më gjerësisht shih: Schmitt, Oliver Jens: “*Arbëria veneciane*”, Tiranë, 2008, ku jipet një tablo e gjerë, ndonëse e mbivlerësuar e raporteve midis Venedikut dhe Skënderbeut, që kanë të bëjnë me praninë e Venedikut në Adriatikon shqiptar thuajse në të gjitha fazat historike dhe rolin që ka luajtur në jepën ekonomike, politike të hapësirës shqiptare.

<sup>819</sup> Fallmerayer, Johann Philipp: “*Das Albanensische Element in Grichenland*”, München, 1866, vëllimi IX, faqe 88.

tingëlluese që arrinin në mijëra dukatë ari nga thesari papal.<sup>820</sup> Kështu, më 1467 Skënderbeu mori si ndihmë 1500 dukatë nga Ferdinandi i Napolit, 3400 nga Venediku dhe 9250 nga Papa Piu II.<sup>821</sup>

Sipas Nolit, arsyet e kësaj përkrahjeje të vazhdueshme ishin të qarta: Skënderbeu ishte aleati i tyre më i sigurt, sepse pothuajse për njëzet e pesë vjet luftoi vazhdimisht kundër armikut të përbashkët, vetëm me dy ndërprerje të shkurtra prej afër gjashtë muajsh secila, të cilat i ngujuan Osmanët në atë pjesë, duke ndikuar dukshëm frenimin e përpjekjeve të tyre që ta kalonin Otranton.<sup>822</sup> Meqë sipas, Papë Kalikasit III, me anën e një letre kishte pranuar se Skënderbeu kishte bërë për fenë më tepër se gjithë princat e tjerë katolikë, këshillon legatin e tij t'i dorëzonte Mbretit të Bosnjës një pjesë të fondeve të mbledhura në Dalmaci për kryqëzatën e re, që ky, i nxitur nga ndihma financiare, të bëhej “një Skënderbe tjetër”.<sup>823</sup>

Krahas Selisë së Shenjtë, ishte Napoli që më së shumti do t'i ketë ndihmuar Skënderbeut nga çdo pikëpamje. Kjo ishte edhe e arsyeshme ngaqë bregu lindor i mbretërisë së Napolit gjendej vetëm pesëdhjetë milje larg, në disa pika midis Brindisit dhe Vlorës. Kështu, me qëllim vetë-mbrojtjeje, mbretëria e Napolit i ndihmoi Skënderbeut për ta zgjatur qëndresën e tij dhe për ta mbrojtur Arbërinë, e cila ishte, në njëfarë kuptimi, një kryeurë napolitane.<sup>824</sup>

Veç kësaj, nuk ishte vetëm ndjenja e vetëmbrojtjes që e nxiti qëndrimin e mbretërve napolitanë, po edhe ëndrra e tyre për të krijuar Perandorinë Mesdhetare Katallane, që do të shtrihej prej Barcelonës deri në Kostandinopojë.<sup>825</sup>

Bashkë me Napolin dhe Siqelinë, Alfonsi V, Mbret i Aragonës, trashëgoi edhe ambiciet e paraardhësve të tij, Frederikut II, Robert Guiskardit dhe Karlit të Anzhuve, të cilët nga vitet 1272-1326 ngritën “Mbretërinë e Arbërisë”, e cila për herë të parë, bashkoi feudalët dhe fisnikët e Arbrit rreth një projekti të tyre shtetëror.

---

<sup>820</sup> Më gjerësisht shih: Farlati, vëllimi VII, faqe 421; Pastor, Ludwig: “*Geschichte des papstums*”, 1891, vëll. IV, faqe 86; Gegaj, Athanas: “*L'Albanie et L'Invasion turque au XV-eme Siece*”, 1937, faqe 144.

<sup>821</sup> Shih: Trichera “*Codice Aragonese*”, faqe 90, shtesa nr. 40; Ljubić, Sime: “Isitine o odnosu izmedju južnog slovenstva i Mletačke Republike”, Zagreb, 1875-1891, Vëll. X, nr. CCCC, faqe 387; Pastor, Vëll. IV, faqe 86; Gegaj, Athanas: “*L'Albani et L'Invasion turque au XV-eme Siece*”, 1937, faqe 144-45.

<sup>822</sup> Noli, Fan S: “*Gjergj Kastrioti Skënderbeu*”, Tiranë, 1967, faqe 49.

<sup>823</sup> Shih Theiner, Augustinus: “*Monumenta Slavorum*”, Romë, 1863, Vëll. I, nr. DCII, faqe 427-8, shtesa nr. 15; Makushev, Vikentije Vasilević: “*Istoričeskia Razyskania o Slavjanah v Albanii v Srednieg Veka*”, Varshavë, 1871, faqe 93.

<sup>824</sup> Noli, Fan S: “*Gjergj Kastrioti Skënderbeu*”, Tiranë, 1967, faqe 50.

<sup>825</sup> Shih: Jorga, Nicolae: “*Breve Histoire de l'Albani et du Peuple Albanias*”, Bukuresht, 1919, faqe 47.

Edhe përkundër kësaj ndihme të madhe që Skënderbeu mori nga Napoli dhe lidhjet e tij të njohura me Alfonsin V kur ai shkoi në Napoli dhe ia siguroi kuroren mbretërore kur e kishte në rrezik, Noli refuzon tezën se lidhjet e Skënderbeut me Napolin e kishin kthyer atë në një “*condottiere*” (mercenarë) të thjeshtë në shërbim të Napolit ose të Venedikut, siç vlerësohej nga Jorgo, Langer e disa të tjerë.<sup>826</sup>

Kjo teori, në forma të ndryshme do të arrijë deri në ditët tona si konstrukt i “*Shqipërisë Veneciane*”,<sup>827</sup> me ç’rast gjendjet e natyrshme, siç ishin ato tregtare me Venedikun, por edhe lidhjet dhe aleancat e detyrueshme me Republikën në prag dhe gjatë pushtimeve osmane, pa përfshirë këtu edhe ato që Skënderbeu i kishte pranuar në kushte të rënda që t’i mbajë jashtë pushtimeve osmane, të pasqyrohen kryesisht si çështje e një “dominimi” shoqëror, kulturor dhe politik venecian ndaj botës arbërore. Edhe pse kjo do të dëshirohej prej arbërorëve, megjithatë, realitetet tregojnë, se prania e Venedikasve rrudhej vetëm në nivel të tregtisë dhe asgjë më shumë.<sup>828</sup>

Krahas mbivlerësimit të rolit të Venedikut në raport me Skënderbeun dhe luftën e Arbërve kundër pushtimeve osmane, ka edhe kundërime dhe vlerësime skajshmërisht të kundërta, siç ishte ai i polakut Makushev, me ç’rast, politika e Venedikut në tokat e Arbrit të sunduara prej tij, jashtë çdo atributi qytetëruar dhe përkatësisë perëndimore të saj, gjë që ka pasur edhe ndikimin e vet të drejtpërdrejtë si alternativë ndaj bizantizmit dhe politikës pushtuese të Sllavëve, përshkruhet si “një luftë shfarosëse kundër klasave shoqërore arbërore”.<sup>829</sup>

Ja si arsyeton ky autor sjelljen politike të Venedikut:

“Në qytetet arbërore të Durrësit, Leshit, Shkodrës, Drishtit, Ulqinit e Tivarit, që kishte aneksuar Venediku, aristokracia po poshtërohej, borgjezia po rrënohej dhe fshatarësia e lirë po bëheshin bujkrobër. Në përgjithësi, aneksimi i tokës arbërore vinte pastaj si faza e fundit e këtij procesi. Krerët e fiseve arbërore ishin të subvencionuar dhe të nxitur ta luftonin Turqinë deri sa të mbyteshin në gjak dhe të shtrëngoheshin pastaj t’i jepeshin pa kushte Venedikut, si një e keqe më e vogël se sa Turqia. Mbas nënshtrimit të tyre, ata trajtoheshin si skllëvër të një vendi kolonial. Kur krerët e fiseve ishin tepër të fortë për t’u shtypur prej turqve,

<sup>826</sup> Noli, Fan S: “*Gjergj Kastrioti Skënderbeu*”, Tiranë, 1967, faqe 51.

<sup>827</sup> Shih: Schmitt, Oliver Jens: “*Shqipëria veneciane*”, Tiranë, 2007.

<sup>828</sup> Po aty.

<sup>829</sup> Shih: Makushev, Vikentije Vasilević: “*Istoričarski Rasyskanja o Slovjana h v Albanii v Srednie Vek*”, Varshavë, 1871, faqe 132 dhe faqe 146-47, cituar sipas Noli, Fan S: “*Gjergj Kastrioti Skënderbeu*”, Tiranë, 1967, faqe 51.

Venediku nuk ngurronte t'u binte me thikë pas shpine, duke nxitur luftën vëllavrasëse midis tyre ose, bile, duke shpallur dhe luftë kundër tyre. Ai kishte shkatërruar Balshajt, dhe shpresonte ta përsëriste të njëjtën metodë edhe kundër Skënderbeut. Tri herë të paktën, Skënderbeu u propozoi venedikasve t'u dorëzonte Krujën, me qëllim që ta shpëtonte atë nga turqit (më 1449, më 1450 dhe më 1466), por venedikasit nuk pranuan, sepse besonin që Skënderbeu, me malësorët e tij, ishte tepër i fortë për t'u bërë shërbëtor i tyre i bindur. Ata donin më mirë ta shihnin Krujën të sunduar prej turqve se sa ta zotëronin vetë, para se banorët e saj të ishin shkatërruar dhe mundur. Fakti se ata e morën përsipër mbrojtjen e qytetit vetëm mbasi vdiq Skënderbeu më 1468, dhe aneksuan qytetin vetëm më 1474, kur populli ishte i ronitur dhe mund të skllavërohej me siguri. Në këtë mënyrë Venedikasit lejuan që gjithë qytetet e Jugut të Arbërisë të binin në duart e Turqve, ndonëse herë pas here u qe dhënë rast që t'i merrnin nën mbrojtjen e tyre, po të kishin dashur t'i pranonin.

Është e qartë se Venedikasit mendonin, që Arbëria mund t'u rrëmbehej Turqve shumë më lehtë se sa Arbërve vetë. Mjaft e çuditshme është që, pos disa ndërprerjeve të shkurtra, ata vazhduan të subvencionojnë Skënderbeun, ndonëse e urrenin me gjithë shpirt! Ata ndoqën një politikë të tillë, ngandonjëherë, sepse donin t'u bënin luftë turqve, po pa u dukur, që të mbronin kolonitë e tyre në Arbëri.”<sup>830</sup>

Ngjashëm me historianin polak shprehet edhe rumuni Jorga.<sup>831</sup>Ai vlerëson se Venedikasit ishin të detyruar të bënin paqe me Skënderbeun, si për shembull më 1448 dhe 1451, kur ai po korrite fitore pas fitoresh dhe mund t'ia rrezikonte kolonitë, dhe herë të tjera, sepse ishin trembur për vdekje nga Mehmeti II, si në vitin 1453 pas rënies së Kostandinopojës, dhe herë të tjera pse ata prapë ia kishin nevojën së tepërmi Skënderbeut si një aleat kundër turqve, ashtu si ngjau më 1463-68.<sup>832</sup>

Këtij qëndrimi do t'i bashkëngjitet edhe kroati Lubić kur thotë se: “edhe gjatë kësaj periudhe të fundit, venedikasit u lejuan *proveditorëve* (guverenatorëve) të tyre në Arbëri që ta pengonin Skënderbeun në çdo hap të tij dhe t'i binin me thikë pas shpine. Më në fund Skënderbeu nuk desh të pranonte trupa ndih-

---

<sup>830</sup> Po aty, faqe 52.

<sup>831</sup> Shih: Jorga, Nicolae: “Breve Historie de l'Albani et du Peuple Albanias”, Bukuresht, 1919.

<sup>832</sup> Po aty, faqe 46.



mëse venedikase, përveç se po të viheshin nën komandën e tij të drejtpërdrejtë”.<sup>833</sup>

Përkundër lidhjeve herë të interesit, e herë që iu imponuan nga rrethanat e ndryshme nëpër të cilat kaloi Skënderbeu gjatë luftës së tij heroike, siç ishin ato midis Papatit, Napolit dhe Venedikut, ishin ato me Raguzën, të cilat mund të thuhet se ishin tejet miqësore dhe me dobi të dyanshme.<sup>834</sup>

Qyteti i pasur i Raguzës nuk e harroi kurrë origjinën e tij romake dhe vazhdoi të përdorte latinishten dhe italishten si gjuhë zyrtare. Paraja dhe tregtia ishin të vetmet armë që patricët raguzianë përdornin për të ndihmuar gjithë ata që luftonin Turqinë, pushtuesin më të rrezikshëm të asaj kohe.<sup>835</sup>

Meqë Skënderbeu kishte marrë flamurin e asaj lufte, ai ishte aleat i tyre natyral, si dhe një klient që blinte mallrat e tyre. Ata vepronin edhe si bankierë të tij.<sup>836</sup>Lidhja bëhej edhe më miqësore edhe për faktin se qyteti kishte një popullatë të madhe arbrish, dhe disa Arbër kishin arritur të ngriheshin në radhët e klaseve të larta. Midis patricëve gjendeshin edhe pjesëtarët e familjeve nga Drishti: Suma, Polombo, Lapore dhe Span. Ashtu si gjithë qytetet e Dalmacisë së Jugut, Raguzë kish shumë klerikë dhe murgj arbërorë që kishin në dorë pothuajse gjithë shërbimet kishtarë.<sup>837</sup>

Kjo i shpjegon marrëdhëniet e përzemërta që ekzistonin midis Raguzës dhe Skënderbeut, si dhe pritjet e shkëlqyera që iu bënë këtij çdo herë që vizitoi qytetin. Andaj, nuk është për t'u habitur, pse Raguzë, ditën e vdekjes së Skënderbeut e shpalli ditë zie të përhershme.

## VDEKJA E SKËNDERBEUT DHE FUNDI I FISNIKËRISË ARBËRORE

---

<sup>833</sup> Lubić, Sime: “*Istine o odnosu između južnog slovenstva i Mletačke Republike*”, Zagreb, 1875, Vëll. X, f. 334.

<sup>834</sup> Më gjerësisht rreth raporteve të Skënderbeut me Venedikun dhe ato osmano-venedikase dhe luftën e tij në dy fronte shih: Barleti, Marin: “*Skënderbeu*”, Prishtinë 1968; Noli S, Fan “*Gjergj Kastrioti Skënderbeu*”, Tiranë 1957 80-102; Gegaj, Athanas “*A' Albaue et l'Invasion Turque au XV siecle*”, Paris 1937; Plasari, Aurel: “*Skënderbeu*”, Tiranë 2010 389-414; Frashëri, Kristo: “*Gjergj Kastrioti Skënderbeut*”, Tiranë 2002 faqe 143-162; Biçoku, K: “*Disa aspekte të marrëdhënieve të Skënderbeut me Venedikun*”, në “Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike”, vëll. I, Tiranë 1969 faqe 67-74; Schmitt, Jens Olivirt: “*Shqipëria veneciane*”, Tiranë 2002.

<sup>835</sup> Noli, Fan S: “*Gjergj Kastrioti Skënderbeu*”, Tiranë, 1967, faqe 52.

<sup>836</sup> Miklosich, Franz: “*Monumenta Serbica Spectantia Hisoriam Serbia, Bosna, Ragusi*”, Vjenë, 1858, faqe 442.

<sup>837</sup> Shih: Šufflay Milan: “*Acta et Diplomata*”, si dhe “*Illyrisch-Albanische Forschungen*”, vëll. I, Vjenë, 1924, faqe 265.

Vdekja e Skënderbeut në vitin 1468 nga ethet e malaries do të paraqesë fillimin e një fundi të njërës ndër përpjekjet më të mëdha historike të Arbërve dhe të shtetit të tyre feudal të krijuar asokohe në luftë kundër Osmanëve për më shumë se një çerek shekulli. Në këtë rrethana, kjo luftë e vetme e asaj natyre dhe atyre përmasave, doemos i shërbente edhe mbrojtjes së qytetërimit perëndimor nga pushtimi lindor, gjë që nuk ishte e rastit se do t'i jepen edhe epitetet më të lartë nga papati me propozimin për shugurimin *Mbret i Arbërisë*<sup>838</sup> e deri tek shpallja “*për engjëll shpëtimtar të krishterimit*” dhe të ngjashme, të cilat figurën e tij do ta veshin edhe me ngjyrimet mitike.

Përkundër atyre që e kanë përcjellë Skënderbeun dhe shfaqjen e tij nga personaliteti historik ndër më të mëdhenjtë e kohës e deri tek ai mitik, mbetet i pamohueshëm qëndrimi se në këtë luftë Arbrit hynë si rebelë të parë kundër pushtimit osman, me ç’rast ata u kurorëzuan me oreolin e fitores së parë të europianëve në luftën me Osmanët, fitore kjo që ndonëse nuk do të jetë në gjendje që të materializohet në përputhje me parashikimet e Skënderbeut, tagrin e saj do ta inkasojë edhe krishterimi perëndimor, qoftë edhe si të përkohshëm dhe këtë do ta shfrytëzojë në mënyra të ndryshme madje edhe si kapital moral dhe shpirtëror në luftën e mëtejshme kundër depërtimit të islamit.

Edhe pse shteti feudal i Arbrit, i mbetur pa *zot*, vazhdoi t’u bëjë ballë sulmeve osmane edhe për disa vjet të tjera, nuk do t’i shpëtojë më të keqes, pra ripushtimit osman, si dhe ndëshkimit të ashpër dhe robërisë pesë-shekullore, që do t’i vijë më pas. Dhe, kjo humbje për Arbrit krahas disfatës ushtarake dhe rrënimit të të gjithë ngrehinës shtetërore të ndërtuar me aq mund të madh gjatë luftës çerekshekullore kundër fuqisë më të madhe ushtarake të botës, do të thotë edhe humbje e thellë dhe e shumanshme me pasoja tragjike, që do t’i bëjë disa nga kritikuesit e tij të dikurshëm dhe të sotëm, të shtrojnë pyetjen se a ia vlejti barra qiranë fare, meqë sipas tyre, vendi u ndëshkua rëndë, ndërkohë që pasojat e asaj humbje vazhduan të prodhojnë pasoja të rënda për Arbrit edhe më vonë deri

---

<sup>838</sup> Shih Kodeksi i pabotuar i Engjëllit në latinisht, i cili ruhet në Bibliotekën Laurentianis të Firencës (Itali), ku thuhet se papa Piu II kishte propozuar që Skënderbeu të shugurohet “*mbret i Shqipërisë*”, ka këtë përmbajtje: “*Dekret i përgjithshëm i zotit tonë Piu II, i shenjtëruar me hirin hyjnor Papë, i cili me kërkesën e shumë të përndershmit dhe shumë të shkëlqyerit Kardinalit të Kishës së Shenjtë Romake, Kryepeshkopit të Durrësit, zotit Engjëlli e ka shëlbue zotin Skënderbe luftëtarin e pathyeshëm kundër sektit mysliman, mbret të Shqipërisë*”. Cituar sipas Kristo Frashërit “*Skënderbeu i shpërfytyruar*”, Tiranë 2009, faqe 112.

aty sa të mendohet se ata ta harrojnë edhe emrin Arbër dhe Arbëri që pastaj të zëvendësohet me atë Shqiptar dhe Shqipëri?<sup>839</sup>

Ata që mendojnë kështu kanë parasysh ato që do t'i ndodhin Arbërisë pas ripushtimit nga Osmanët, kur i gjithë vendi iu nënshtrua një terrori të paparë, në njërën anë si hakmarrje ndaj humbjeve që kishin pësuar dy nga sulltanët më të fuqishëm të kohës para mureve të Krujës, Murati II dhe Mehmeti II dhe në tjetrën anë të ndëshkimi i rëndë që merrnin ata, që duhej t'u shërbente si mësim se çfarë i pret nëse i kthehen rebelimit, sidomos rikthimit të shteteve të tyre.<sup>840</sup>

Si pasojë e këtyre veprimeve fillimisht kemi shpërnguljen e një pjese të madhe të popullatës arbërore përtej detit, në drejtim të Jugut të Italisë dhe në pjesët e tjera të Europës dhe pastaj masat e shumta represive ndaj atyre që do të mbesin në atdhe. Burimet e ndryshme të kohës bëjnë të ditur se kjo shpërngulje do të fillojë edhe para se të vdesë Skënderbeu, por ajo do të marrë përmasat shqetësuese menjëherë pas vdekjes kur rrugën e eksodit do ta marrë edhe e shoqja e Skënderbeut, Donika bashkë me të birin 13 vjeçar, Gjonin.<sup>841</sup>

Kjo shpërngulje në njëfarë mënyre ishte e paraparë nga një marrëveshje që Skënderbeu kishte bërë me Alfonsin e Napolit në të cilën parashihej që farefisi i tij dhe një pjesë e bujarisë të strehohej atje, jo përgjithnjë, por që të mbrohej dhe të përgatitej për t'u kthyer në atdhe çastin që për këtë do të krijoheshin rrethanat.<sup>842</sup>

Ishte e natyrshme që krahas familjes së Skënderbeut atë rrugë ta marrin edhe pjesa më e madhe e bujarisë shqiptare, fisnikët, tregtarët dhe disa nga feudalët. Më vonë atyre do t'u bashkohen edhe ushtarakët dhe luftëtarët e njohur të Skënderbeut, të cilët do të vihen në shërbim të republikave detare nga ajo e Venedikut, Gjenovës dhe e Napolit dhe shumë prej tyre do të shkojnë edhe deri në Spanjë dhe vende të tjera duke shërbyer si mercenarë.

---

<sup>839</sup> Shih Eduard Gibson "History of the Decline and Fall Roman Empire" (Historia e muzgut dhe e rënies së Perandorisë Romake), botuar në Londër, më 1900; Oliver Jens Schmitt "Skënderbeu", Tiranë 2009; pastaj Husamedin Feraj: "Skicë e mendimit politik shqiptar", 1998; Driton Egro: "Një qasje kritike studimeve osmane në historiografinë moderne shqiptare", Tiranë 2007.

<sup>840</sup> Më gjerësisht rreth terrorit osman te Pulaha S. "Lufta shqiptaro-turke në shekullin XV. Burime osmane", Tiranë 1968, shih: "Kronikën e Tursun Beut" dhe "Luftërat shqiptaro-turke në veprat e kronistëve osmanë të shekujve XV-XVII", në "Studime Historike", 1/1968, f 121-153 si dhe "Studime për Epokën e Skënderbeut", vëll. II, Tiranë 1989, faqe 391-435.

<sup>841</sup> Donika Kastrioti, bashkë me të birin, Gjonin, u largua për në Itali disa javë pas vdekjes së Skënderbeut dhe u vendos në pronat që kishin në Itali (Monte santa Anxhelo dhe San Xhovani Rotodo).

<sup>842</sup> Më gjerësisht shih Barleti, Marin: "Skënderbeu", Prishtinë 1968; Noli, Fan Stilian: "Gjergj Kastrioti Skënderbeu 1405-1468", Tiranë 1957; Frashëri, Kristo: "Gjergj Kastrioti Skënderbeu – jeta dhe vepra", Tiranë 2002; Pulaha, Selami: "Skënderbeu", Tiranë 2010.

Para se të ndodhë ky eksod i madh, Arbërorët, veçmas fisnikëria dhe bujarët e rëndësishme që deri në fund kishin mbështetur Skënderbeun, do të vazhdojnë të bëjnë luftën, që kishte nisur ai, por tash në rrethana të reja, të cilat, në mungesë të një personaliteti që do t'i afrohej Heroit, jeta politike e bashkë me të edhe rezistenca filloi të kthehet në gjendjen e para një çerek shekulli, pra kur feudalët shfaqeshin të pavarur dhe silleshin në përputhje me interesat e tyre. Kështu, disa nga familjet e mëdha dolën përsëri zotë më vete dhe filluan të mbështeteshin te Venediku, pa përjashtuar disa që filluan të shikojnë kah Osmanët në mënyrë që të mbrohen duke ripërtërirë marrëdhëniet vasale që kishin me ta.

Venediku ishte ai që tashmë shfaqej si faktor që duhej të vendoste për vazhdimin e rezistencës së mbikëqyrur, gjithnjë në përputhje me interesat e veta dhe, po ashtu të ruante kolonitë dhe zotërimet që kishte në këto pjesë, pa ngurruar që për to të hynte edhe në marrëveshje me Osmanët, siç do të veprojë në të vërtetë. Hapi i parë, që ndërmori Venediku për t'i marrë punët në dorë, ishte të dërgonte në Arbëri Engjëllin, përfaqësuesin shumëvjeçar të Skënderbeut në Venedik, i cili duhej të ndërhynte te familja e Kastriotëve që t'u dorëzohej Kruja dhe zotërimet tjera.<sup>843</sup>

Këtu dhe te kjo çështje do të dalin problemet që do të përcjellin praninë, por edhe ndërhyrjen e Venedikut në kohën pas Skënderbeut, rreth së cilës u bë fjalë në kapitullin e mëparshëm, kur ndërhyrja e Republikës së Detit, në njërën anë do të marrë përsipër vazhdimin e rezistencës së armatosur, që si dihet do të vazhdojë deri në vitin 1479, pra kur do të bjerë Shkodra në duart e Osmanëve, ndërsa në tjetrën anë do të përçajë faktorin arbëror, i cili do të hyjë në luftë me të. Siç ishte rasti me Lekë Dukagjnin dhe disa të tjerë, të cilët do t'i kthejnë sytë kah Osmanët, me të cilët, pak më vonë, do të hyjnë edhe në marrëdhënie të reja vasaliteti.

Kësaj klime, pra të kthimit të Venedikut “në zot shtëpie” në një pjesë të mirë të asaj që Skënderbeu e kishte kthyer në shtet të Arbrit dhe për çerek shekulli kishte vazhduar të shfaqej si i tillë, gjithsesi se do t'i ndihmojë abstenimi dy-tre vjeçar i Osmanëve nga fushëbeteja për arsye të përfshirjes në vise të tjera, veçmas në frontin me Hungarezët, ku ata tashmë synonin prej andej të shpërthenin drejt qendrës së Europës.

---

<sup>843</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, pjesa e parë, Tiranë, 2002, faqe 466.

Por, Osmanët, Arbërisë iu rikthyen në maj të vitit 1474. Këtë herë, nuk iu drejtuan Krujës, ku tashmë ishin vendosur venedikasit, me të cilët Osmanët kishin shumë marrëveshje paqeje, po Shkodrës, e cila shfaqej me një rëndësi të veçantë.

Beteja për Shkodrën zgjati tre muaj, dhe nga fundi i verës, ushtritë osmane të udhëhequra nga bejlerbeu i Rumelisë, Sinan Pasha, u tërhoqën nga rrethimi. Në të kthyer, pasi shkretuan vendin, veçmas kështjellën e Dejës, e cila një kohë u mbrojt nga Lekë dhe Nikollë Dukagjini, por në fund u bë shkrumb e hi. Pas dy vitesh, Osmanët u kthyen prapë me një ushtri edhe më të madhe.

Këtë herë rrethuan Krujën, e cila mbrohej nga forcat e përbashkëta arbërore-veneciane, të cilave u ishin bashkuar edhe 300 stratiotë të sjellë nga Morea. Rrethimi i Krujës zgjati dy vjet deri më 16 qershor të vitit 1478 kur forcat osmane, të drejtuara nga Mehmeti II, detyruan mbrojtësit të dorëzohen, pasi që atyre t'u jetë premtuar largimi i lirë nga qyteti.

Osmanët, nuk e mbajtën premtimin që mbrojtësit të largoheshin të lirë.<sup>844</sup>Përkundrazi, pos qeveritarit venecian dhe gardës së tij, që u lejuan të largohen, vendorët u vranë pa përjashtim.

Pas kësaj, Sulltani Mehmeti II, iu drejtua Shkodrës dhe në rrugë e sipër pushtoi Drishtin, që e shkatërroi dhe pastaj u futen në kështjellën e Lezhës, e cila ishte braktisur nga komandanti venecian, që drejtonte mbrojtjen e saj. Edhe këtu, vendorët që kishin marrë pjesë në mbrojtje, u lanë në mëshirën e Osmanëve, kështu që të strehuarit në ishullin e Lezhës, u kapën dhe u masakruan para murave të Rozafatit.<sup>845</sup>

Sulltan Mehmeti II, nuk mbeti për të përcjellë marrjen e Shkodrës. Pasi që e kishte të qartë se pushtimi i Arbërisë nuk ishte më çështje e ndonjë prestigji ushtarak, por e lojërave diplomatike me Venedikun, të cilat asnjëherë nuk kishin pushuar midis tyre, në shtator mori rrugën e kthimit në Stamboll. Edhe pse thuhej se trupat e mbetur përreth Shkodrës duhej të vazhdonin rrethimin përderisa uria t'i mposhte Arbërit, pra që të dorëzoheshin, ka shumë gjasa që Mehmeti II kërkonte një marrëveshje me Venedikun, në mënyrë që atë ta mbante larg lidhjeve me Hungarinë dhe vendet e tjera të cilat ai i kishte në shënjestër.

Nënshkrimi i paqes mes Venedikut dhe Perandorisë Osmane, e bërë më 25 janar 1479, pos çështjeve të tjera, që kishin të bënin me ruajtjen e zotimeve venedikase në Mesdhe, përfshinë edhe çështjen e Shkodrës si dhe të disa qyteteve të

---

<sup>844</sup> Po aty, faqe 470.

<sup>845</sup> Më gjerësisht shih Pulaha, S: "*Lufta shqiptaro-turke në shekullin XV. Burime osmane*", Tiranë 1968.

tjera bregdetare (Himarës, Sopotit e të Kastrovilës), të cilat iu dorëzuan Osmanëve. Sipas kësaj marrëveshje Shkodra kalonte në duart e Osmanëve, kurse mbrojtësit dhe banorët e saj mund të largoheshin të lirë prej qytetit të tyre.

Më 25 prill të vitit 1479 forcat osmane hynë në Shkodër. Bëhet e ditur se banorët e saj dhe të pjesëve përreth thuajse në tërësi u larguan dhe u vendosën në rajonin e Venedikut. Bashkë me ta vendin e lëshuan edhe bujarët e njohur Lekë dhe Nikollë Dukagjini, Gjurash Crnojeviqi e të tjerë.<sup>846</sup>

Rënia e Shkodrës dhe e qyteteve të tjera të rëndësishme bregdetare në duart e Osmanëve si dhe pushtimi i kështjellës së Otrantos prej tyre, bëri që vendet perëndimore, përfshirë këtu edhe Venedikun, që kishte nënshkruar marrëveshje me Osmanët dhe një pjesë të mirë të rezistencës arbërore e kishte bërë kurban për interesat e veta, të krijonin një front antiosman, i cili duhej të përqendrohej në Arbëri, meqë ashtu, atje krijohej një prapavijë e pasigurt për trupat osmane që vepronin dhe dërgoheshin në Itali. Ishte po ashtu edhe vdekja e Sulltan Mehmetit II në vitin 1481 dhe kriza politike që ngjalli ajo në Perandori, që Arbit, sërish i faktorizonte, së paku përkohësisht dhe në dobi të Perëndimit.

Me këtë rast nga Napoli dhe aleatët tjerë perëndimorë, u shfrytëzua i biri i Skënderbeut, Gjoni, që të kthehet në vendlindje për të marrë përsipër rezistencën antiosmane, e cila kishte filluar të nxitet nga disa kryengritje në disa pjesë të vendit. Në këtë kohë, në vend u kthyen edhe Nikollë Dukagjini, Lekë Dukagjini, Konstantin Muzaka dhe Gjurash Cërnojeviqi. Ky i fundit bëri marrëveshje me Osmanët dhe pranoi vasalitetin e tyre, por larg këtij qëndrimi nuk ishin edhe feudalët tjerë arbërorë që u kthyen.

Me përkrahjen e fortë të perëndimorëve, Gjon Kastrioti, i cili kishte zbritur në Jug të Durrësit, i përcjellë nga Konstantin Muzaka, i cili do të zbrisë në Himarë, por i ndihmuar edhe nga Dukagjinët në Veri, të cilët do të veprojnë në rajonet e Lezhës dhe të Shkodrës, do të fillojë një front i rezistencës kundër Osmanëve, që do të fillojë të korrë suksese, veçmas në pjesët e mesit dhe ato të Jugut, ku Kastrioti i ri, operonte me sukses, meqë me vete kishte edhe shumë vullnetarë perëndimorë dhe stratiotë, të ushtruar mirë për luftëra të tilla. Madje, në gusht të vitit 1481, Muzaka ia kishte dalë të thyejë forcat e Sulejman Pashës dhe të marrë Himarën. Aty u zu rob bejlerbeu i Rumelisë, Sulejman Pasha, që iu

---

<sup>846</sup> Shih Pulaha S: “Mbi rënien e Skënderbeut”, te “Studime për Epokën e Skënderbeut”, vëll. III, Tiranë 1989, faqe 476-481; Inxhalkhik, Halil: “Perandoria Osmane”, Shkup 2010, faqe 55-57.

dha si trofe lufte Gjon Kastriotit, të cilin pastaj, ai po si trofe, ia dërgoi mbretit të Napolit.<sup>847</sup>

Fitoret e Gjon Kastriotit në Himarë dhe në disa pjesë të tjera, bënë që forcat osmane, të cilat dërgoheshin në Itali, të dobësoheshin nga humbjet me Arbrit, dhe atje të pësonin humbje nga ato të Napolit, të cilat në shtator të vitit 1481 çliruan kështjellën e Otrantos, prej nga Osmanët do të dëbohen nga Italia. Kështu, makthi perëndimor, që i kishte pushtuar ata pas zbarkimit të Osmanëve në Itali, u kalua në saje të luftës që u bë në “prapavijë” nga Arbrit. Me përshtypjen se mund të bënin më shumë, Arbrit, nën drejtimin e Gjon Kastriotit, vazhduan duke iu drejtuar Krujës, me shpresën se do ta merrnin dhe do ta rikthenin shtetin e Skënderbeut. Por, mbetën te muret e saj, sepse sërish do t’u dobësohet përkrahja nga Perëndimi, të cilët rezistencën e tyre e shfrytëzonin për hesape me Osmanët, gjë që pati për pasojë, së pari largimin nga rrethimi i Krujës e pastaj edhe humbjen e kështjellës së Himarës, dhe së dyti, largimin e Gjon Kastriotit në Itali, i cili vdiq më 1502 dhe la pas vetes fëmijët: Gjergjin (Skënderbeun e ri), Konstadinin, peshkop i Izemias që vdiq në vitin 1550 në moshën 20 vjeçare, Ferrantin, që kishte vdekur më 1561, Federikon, që vdiq më 1503 në moshën 15-vjeçare në Valencia të Spanjës, ku u varros me nderime mbretërore, dhe Marian, e cila iu përkushtua artit.<sup>848</sup>

Shfrytëzimi i Arbërve për nevojat e perëndimorëve do të vazhdojë edhe më këndej, për të marrë fund me nipin e Skënderbeut, Gjergj Kastriotin, i cili do të dërgohet në atdheun e gjyshit të famshëm për ta kthyer “Motin e madh”. Ishte kjo më shumë një aventurë e paraparë për dështim, që duhej t’u shërbente Venedikasve për hesape të reja me Osmanët, se sa ndonjë përpjekje se me të mund të bëhej diç. Pas dy vitesh, pikërisht kur disa nga feudalët arbërorë do të fitojnë përshtypjen se mund të bëhet ndonjë kthesë, Osmanët pushtuan Durrësin dhe me këtë i detyruan përfundimisht venedikasit që të heqin dorë nga çfarëdo përpjekje që t’i shqetësojnë me “prapavijën arbërore”, e cila u desh të shuhet pasi që Venediku nënshkroi një marrëveshje të re paqe me Osmanët.

Nipi i Skënderbeut, bashkë me disa feudalët arbërorë, të cilët shfrytëzohehin për kryengritje, në përputhje me këtë marrëveshje shkuan në Shkodër (ndër ta Progon Dukagjini dhe të tjerë), për të kërkuar që t’u ktheheshin zotërimet, të cilat do të qeveriseshin prej tyre nën sovranitetin e Sulltanit. Sanxhakbeu i Shkodrës, Feriz Beu, pranoi shumë prej këtyre kërkesave, ndërsa hodhi poshtë atë të

---

<sup>847</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, I, Tiranë 2002, faqe 474.

<sup>848</sup> Po aty, faqe 457.

Gjergj Kastriotit të ri, i cili u detyrua të kthehej për në Itali, prej nga pastaj kaloi në Qipro, ku pas pak, vdiq në rrethana të dyshimta.

Në pritje të thirrjes së “Motit të madh”, se një ditë mund t’i ktheheshin betimit të *Zotit* për atdheun dhe borxhin ndaj tij, njësitë elite arbërore, të quajtura stratiotë, me shpresën venitëse, do të vazhdojnë të luftojnë nën flamuj të huaj edhe për një kohë të gjatë dhe do të jenë ushtarët më të kërkuar të kohës.

Krahas mbetjes pa elitën shoqërore dhe ushtarake, e cila do të braktisë vendin, një fatkeqësi tjetër e madhe që do ta gjejë Arbërinë pas vdekjes së Skënderbeut dhe rikthimit të Perandorisë Osmane, do të jetë në një rën anë zhvendosja në masë e popullatës nga qyteti në drejtim të pjesëve malore për të gjetur strehim. Kjo për pasojë do të ketë akulturimin e tyre, por në tjetrën anë edhe të shpërnguljen e një pjese tjetër drejt Italisë, e cila në valë të mëdha vazhdoi thujse për gjysmë shekulli.

Popullatës së Moresë (Peleponezit), e cila filloi të shpërngulej edhe para se të fillojë lufta me Osmanët dhe do të vendoset kryesisht në Kalabri të Sicilisë, do t’i bashkohen një pjesë e madhe e arvanitasve të Greqisë, të cilët humbjen e luftës me Osmanët do ta përjetojnë si humbje të përhershme të atdheut.

Në këto rrethana vlerësohet se rreth një e treta e popullatës arbërore do të braktisë përgjithmonë Arbërinë. Ata që do të mbesin, pa bujarinë dhe pa fisnikërinë arbërore, pa priftërinj të mjaftueshëm që t’i kenë kurdoherë pranë dhe pa mbikëqyrjen më të vogël shpirtërore, nuk do të kenë zgjidhje tjetër, pos që të pranojnë robërinë në përputhje me ligjet e mbijetimit, ku pranimi i islamit paraqitet si faktor i pashmangshëm.

Ndonëse nga pikëpamja formale pranimi i islamit nuk kushtëzohej, meqë Perandoria Osmane ruante tolerancën fetare dhe kjo më së miri do të dëshmohet në raport me kishën ortodokse, e cila thujse “vullnetarisht” Sulltanit ia dorëzoi autoqefalinë dhe prej saj do të përfitojë shumë popullata e krishterë për ta ruajtur identitetin e vet shpirtëror - megjithatë, Arbrit do të jenë të vetmit nga popujt e krishterë të Ilirikut që nuk do të jenë në gjendje që identitetin fetar të krishterë ta shfrytëzojnë në dobi të ruajtjes së qenies së tyre, siç do të veprojnë Sllavët, Greqët, Bullgarët dhe të tjerët. Arsyet janë fare të thjeshta. Dhe ato lidhen me faktorin kishë dhe pengun e vijës së perandorit Teodosi nga shekulli i katërt dhe të ndarjes përfundimtare të kishës në shekullin njëmbëdhjetë, në atë të ritit latin me seli Romën dhe atë të ritit ortodoks, me seli në Kostandinopojë, ku Arbrit do të gjenden në të dy anët dhe me prirjet e vazhdueshme të kapërcimit nga njëri rit



në tjetrin, gjithnjë në përputhje me aleancat që vendoseshin dhe raportet që dilnin prej tyre.

Nëse mund të thuhet se para dhe gjatë kohës së Skënderbeut gjeografia kish-tare me tri pamje (atë të ritit katolik, të ritit ortodoks dhe unit), ishte dukshëm në të mirë të asaj katolike, ku edhe dioqezat ortodokse nga koha e “Mbretërisë së Arbërisë” të Karlit të Parë Anzhu ndonëse ruanin ritin ortodoks, ishin lidhur me Selinë e Shenjtë, pas ripushtimit osman, gjendja do të ndryshojë dukshëm në dobi të ritit ortodoks. Burimet e kohës bëjnë të ditur se jo vetëm dioqezat “e luhatshme”, që ishin lidhur me Selinë e Shenjtë, do t’i kthehen Kostandinopojës, por edhe ato katolike, shumë prej tyre do të detyrohen të konvertohen në ritin ortodoks, sepse ashtu shpëtonin nga ndjekja e egër që u bëhej nga Osmanët, të cilët u kishin shpallur luftë jo vetëm besimtarëve katolikë, por edhe klerikëve dhe kishës së tyre në përgjithësi që e konsideronin kishë të “tradhtarit Skënderbe”, të cilit duhej shuar gjurmët.<sup>849</sup>

Në këtë gjendje dhe me hipotekën e kësaj ndarjeje Arbrit do të fillojnë edhe jetën nën pushtimin Osman të hendikepuar dyanshëm: në njërin anë pse nga mungesa e autoqefalisë së kishës së tyre ortodokse do të jenë të detyruar që shpirtërisht t’i nënshtrohen kishës greko-sllavo-ortodokse, dhe në tjetrën anë, pse besimtarët e ritit katolik, për shumë kohë, do të mbeten thuajse të shkëputur dhe me përkujdesje të kufizuar shpirtërore, për faktin se kleri katolik në Arbëri, në masë të madhe, do të mbetet i shkëputur nga Vatikani. Madje, do të shihet se edhe marrëveshja e Selisë së Shenjtë me Portën e Lartë rreth organizimit të kishës katolike në Arbëri, të shumtën, do të kalojë nëpër “filtrat territorialë” të kishës sllavo-ortodokse, meqë me ndarjen e re administrative asaj do t’i lihet nën mbikëqyrje pjesa më e madhe e hapësirës arbërore.

Përballë kësaj gjendje, pjesa e Arbërve, të besimit ortodoks që do t’i nënshtrohen kishës greko-ortodokse, deshën apo nuk deshën, do të jenë të detyruar të pranojnë sllavizimin ose greqizimin, nga shkakut se këtyre kishave u lejohej me-sha në gjuhën e tyre amtare, ndërkohë që besimtarët e ritit latin edhe më kënde-j mbeteshin me meshën në gjuhën latine dhe nën dirgjimin e qendrës, ku shumica e klerikëve vazhdonin të mos ishin Arbër. Më vonë, me shfaqjen e urdhr-it dominikan dhe atij françeskan në Arbëri, do të bëhen disa ndryshime në këtë drejtim, por edhe ato nuk do të jenë në gjendje të përmirësojnë pozitën e vështirë

---

<sup>849</sup> Pisko, Julius Ernest: “*Skanderbeg, Historische Studie*”, Wien, 1894, faqe 162.

të besimtarëve katolikë në Arbëri, veçmas të atyre nga dioqezat që do të shtrihen në hapësirën e juridiksionit të kishës sllavo-ortodokse greke.

Në këto rrethana, ruajtja e identitetit fetar të krishterë për Arbrit, nuk do të thoshte njëherësh edhe mbrojtje e qenies së tyre shpirtërore. Përkundrazi, për ata të përkatësisë së ritit sllavo-ortodoks, kisha sllave dhe ajo greke, ngase ishte pranuar vasaliteti i sulltanit dhe patrikana e Kostandinopojës në disa segmente (sistemi tatimor dhe ai i administrimit vendor), ishte kthyer edhe në pjesë të mekanizmave të Pushtetit Osman. Me këtë status, kisha ortodokse me gjuhën liturgjike në greqisht, bullgarisht dhe sllavisht, në të vërtetë, identitetin e krishterë, fillimisht do ta kthejë në identiteti etnik (në përputhje me shtrirjen e gjuhës së liturgjisë), ndërsa, më vonë, kur do të fillojnë lëvizjet nacionaliste, në platformë të identitetit kombëtar. Ndërkohë që për besimtarët e ritit katolik, ruajtja centraliste e mbi-këqyrjes nga ana e Selisë së Shenjtë me predikimin unik të meshës në gjuhën latine dhe jashtë çfarëdo pranie fizike me të, krijonte dyshimin e sakrificimit pa kurrfarë kundërvlere shoqërore.

## KAPITULLI I TRETË

### MIDIS LINDJES DHE PERËNDIMIT

#### NË KËRKIM TË RILIDHJES ME QYTETRIMIN PERËNDIMOR

Është vlerësuar me të drejtë se turqit osmanë, ndërsa i dhanë një grusht të rëndë rrënues jetës kulturore të mëparshme, qenia e së cilës ishte e lidhur me Perëndimin që nga antikiteti, nuk qenë në gjendje të zëvendësonin atë qysh në fillim me kulturën e tyre islamike. Në shekujt XV-XVI ata e paraqisnin veten si trashëgimtarët e kulturës islame, por kjo kulturë që lëvruar në gjuhët arabishte e persishte, të cilat pak Turq i kuptonin. Klasa feudale e spahinjve dhe shërbyesit e fesë myslimane që vepronin në Shqipëri dhe që do të duhej të ishin bartësit e kulturës islamike, në përgjithësi kishin origjinë shqiptare dhe shumë pak i njihnin gjuhët turqishte, arabishte e persishte. Veç kësaj, regjimi i timareve, nga vetë karakteri i tij ushtarak, nuk i jepte ndonjë nxitje zhvillimit kulturor, pasi kujdesi kryesor i klasesë feudale vendëse ishte të nxirrte rentën feudale nga fshatarët. Të gjitha këto solla si pasojë që Shqipëria e shekullit XVI, në pamundësi të ruante vazhdimësinë e qytetërimit me të cilin ishte thadruar, dhe nga paaftësia reale që të pranonte qytetërimin islam në përputhje me dinamikën e proceseve shoqërore dhe politike që solla rrethanat osmane, të zhytej në një prapambetje të theksuar kulturore.<sup>850</sup>

Të dhënat bëjnë të ditur se pushtuesve osmanë iu desh më shumë se një shekull që në Shqipëri të hapin disa shkolla të pakta turqishte, të ngritura me pasurinë e vakufuara nga besimtarët e pasur myslimanë. Këto qenë shkolla fetare islame, në nivelin e shkollave fillore (meqtebe), që synonin t'u mësonin nxënësve leximin e "Kuranit" për të shërbyer pastaj në xhamitë e vendit. Pra, Osmanët, nuk synonin ngritjen dhe emancipimin e masave, e as të besimtarëve në pikëpamje kulturore meqë kjo do të nënkuptonte një qasje krejt tjetër, pos t'i venin në varësi të plotë nga pikëpamja e dëgjueshmërisë, duke i mbajtur në gjendjen e një injorance të plotë. Ky aspekt madje do të dalë në pah në prag të pavarësisë kombëtare kur mbi 97% e popullatës ishte analfabete.

---

<sup>850</sup> "Historia e Popullit Shqiptar", vëllimi i parë, Prishtinë, 1969, faqe 347.

Kleri i krishterë, veçmas ai katolik, edhe pse me telashe të ndjeshme në rrethanat e reja, pas vështirësive të fillimit që do të ketë me shfaqjen e Reformacionit në Gjermani, do t'i kthehet strategjisë së mbrojtjes së besimtarëve të vet në Arbëri në pikëpamje të kuadrove, duke i ripërtërirë, me synimin që në të të përfshiheshin edhe Shqiptarë. Në koncilin e Torentos, të vitit 1540, kisha katolike vendosi të riorganizonte klerin katolik në Ilirik dhe sidomos atë të dobësuar së tepërmi në Arbëri, i cili nga 20 manastire me 120 murgj që kishte në pragun e pushtimit osman, më 1570, kishte mbetur me 4 manastire dhe 11 murgj.<sup>851</sup>

Në Koncilin e dytë të Torentos, më 1570, Roma mori vendimin për hapjen e disa kolegjeve të posaçme për klerin e vendeve të ndryshme të botës, ashtu edhe për klerin shqiptar e atë në Ilirik. Një nga shkollat e para të kësaj natyre ishte “*Kolegji i Shën Athanasit*”, i themeluar në Romë, në vitin 1572, nën drejtimin e murgjve bazilianë, posaçërisht për nxënësit arbëreshë e grekë të Italisë të kthyer në unitë. Një shkollë e veçantë për nxënësit katolikë të Dalmacisë u ngrit më 1580 në Loreto me emrin “*Kolegji ilirik*”, të cilën e vijuan edhe klerikë shqiptarë dhe si do të shihet, do të jenë disa nga rrethi i këtyre nxënësve klerikë të cilët do të bëjnë që arsimit shqip dhe letërsia shqipe të fillojnë jetën e vet të pandalshme.<sup>852</sup>

Këta dy hapa, megjithatë, nënkuptonin një marrëveshje të re me Portën rreth pranisë së kishës katolike në vendet e pushtuara me përkushtimin që së pari të ruhet hapësira e saj në raport me kishën ortodokse, e cila nën sovranitetin e Portës shfaqej me përparësi ngaqë ajo autoqefalinë ia kishte nënshtuar Sulltanit. Po ashtu nënkuptonte përkthimin e librave kishtarë në gjuhën shqipe si dhe botimin e tyre, gjë që nuk ishte punë e lehtë, nëse kihej parasysh fakti se Selia e Shenjtë kishte disa marrëveshje parimore me Portën, por jo aso të veçanta, që preknin raportet e ritit, ku kisha ortodokse kishte hapësirë veprimi dhe ndikimi prej nga mund ta shfrytëzonte autoritetin, siç do të ndodhë në të vërtetë, që përkatësia lindore të identifikohet me etninë sllave. Ky faktor pastaj, më vonë, është shfrytëzuar për qëllime nacionaliste dhe hegjemoniste. Kështu që hapi i parë lidhej me një fushatë të përqendruar të katolicizmit nën frymën e të ashtuquajturit *unitizëm*, që popullsia shqiptare e besimit ortodoks të shkëputej sa më shumë që të ishte e mundur nga kisha e Lindjes dhe t'i bashkohej asaj të Romës.<sup>853</sup>

---

<sup>851</sup> Rreth gjendjes së klerit katolik në Shqipëri shih: *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustratia, collegerunt et digesserunt Thollpezy, Jireček, Šufflay*, II vol. Vindobonac 1913-1918; Farlaus: “*Illyrici sacri*” tom. I-VIII, Venetiis 1751-1819; Gjini, Gaspër: “*Skopsko-prizrenska biskupija kroz stoljeća*”, Zagreb 1968; Radonić: “*Zapadna Europa i balkanski narodi prema Turcima u prvjoj polovini XV veka*”, Novi Sad 1905.

<sup>852</sup> Po aty, faqe 348.

<sup>853</sup> Po aty, faqe 348.

Misionarët e *lëvizjes uniate* në Arbëri u bënë murgjit bazilianë. Qysh në fillim të shekullit XVI ekiye nga radhët e murgjërësë bazilianë erdhën nga Italia dhe u vendosën në pjesën e mesme e të jugut. Në Himarë korrën suksese të ndjeshme, meqë në fushatën e tyre himarjotëve u premtonin se me kalimin në *unitë*, Roma do t'u ndihmonte me armë e mjete të tjera në luftë kundër sundimtarëve turq. Fushata e *unitizmit* vazhdoi edhe gjatë shekullit të ardhshëm, por Patrikana e Stambollit, në saje të lidhjeve të mira që kishte vendosur me Portën e Lartë dhe me sulltanin, ia doli që t'i rikthejë disa nga pozicionet e humbura, dhe kjo do t'i shkojë për dore nga që Roma nuk ishte në gjendje ta mbajë premtimin se do t'u ndihmonte për ta rikthyer lirinë e humbur. Përkundrazi, kisha ortodokse nga shekulli XVI, bëri që në jug të hapen disa shkolla fillore në gjuhën greke<sup>854</sup>, ndërkohë që të ngjashme, më vonë, por në sllavishte, ato u hapën edhe në Kosovë dhe në Maqedoni, me çka u krijuan rrethana të përshtatshme për greqizimin dhe sllavizimin e një pjese të mirë të besimtarëve ortodoksë në këto vise në përputhje me gjuhën e liturgjisë.<sup>855</sup>

Beteja e humbur e uniatëve në Epir, në Maqedoni dhe në Dardani me kishën greke dhe atë sllave, kishën katolike do ta përqendrojë tek besimtarët e ritit katolik, kryesisht në veri, në Dardani, por edhe në bregdet. Në kushtet e sundimit osman dhe të kryengritjeve të vazhdueshme të Shqiptarëve kundër tij, përpjekjet për ta shpëtuar besimin e krishterë kishin edhe për klerin e ndërgjegjshëm, jo vetëm një kuptim fetar por edhe patriotik. Duke mbrojtur fenë e krishterë kundër islamizimit, ata synonin ta largonin rrezikun e asimilimit të Shqiptarëve nga turqit osmanë.<sup>856</sup>

Njëri ndër ata priftërinj të ndërgjegjshëm, që do të veprojnë dhe punojnë drejt plotësimit të këtij misioni shfaqet Don Gjon Buzuku, i cili në vitin 1555, botoi "*Mesharin*", shqip me pjesë të përkthyer nga ungjilli, rituali dhe liturgjia.<sup>857</sup>

"*Meshari*" do të zbulohet nga prelati shqiptar nga Gjakova, Gjon Nikollë Kazazi, një nga shkrimtarët e hershëm të Veriut. Në vitin 1740, duke u ndodhur në Kolegjin e Propagandës Fide, ku Gjon Nikollë Kazazi kishte qenë nxënës dikur, pa me habi librin dhe kopjoi një copë rituali prej tij dhe ia dërgoi në shenjë nderimi Atë Guzetës, themelues i Seminarit të Palermos me përkushtimin "*Meshari i lashtë shqip krejt i grisur prej vjetërsie*". Rektorët e mëvonshëm të këtij Seminarit, Pal Parino e Sepë Krispi e patën nëpër duar këtë fragment dhe e përmendin në shkrimet e tyre. Pastaj libri ra prapë në harresë. Aty nga mbarimi i shekullit XVIII

---

<sup>854</sup> Po aty, faqe 348.

<sup>855</sup> Radonjić, J: "*Kurija u Južnoslovenske zemlje, XVI-XIX*".

<sup>856</sup> Gjini, Gaspër: "*Skopsko-prizrenska biskupija kroz stoljeća*", Zagreb 1986.

<sup>857</sup> Shih: "*Meshari i Gjon Buzukut (1555)*" I, II, Prishtinë 1987.

nga biblioteka e Kolegjit të Propagandës u dërgua në koleksionin e librave orientale të kardinalit Stefan Borgia, deri sa më në fund, bashkë me këta libra, kaloi në Bibliotekën e Vatikanit, ku gjendet nën sinjaturën *R(accolta) G(enerale) Liturgia*. III. 194, si i vetmi ekzemplar që dihet deri më sot.<sup>858</sup>

Gjurmimet e para të monumentit të gjuhës shqipe i bëri peshkopi i Arbëreshëve të Italisë, gjurmues e studiues i teksteve të vjetra, Pal Skiroi. Më 1909 Skiroi mori në shqyrtim veprën dhe në saje të një pune shumëvjeçare nxori fotografimin e gjithë tekstit si dhe transliterimin fonetik të tekstit, por nuk ia doli ta botojë në tërësi. Ndërkaq, më 1929 Justin Rrota nxori në Vatikan tri fotokopje të librit. Me botimin e disa pjesëve të zgjedhura e të komentuara të tekstit e me një radhë studimesh të vijua ky studiues i gramatikës e i literaturës së vjetër shqiptare ka ndihmuar shumë në përhapjen e këtij monumenti gjuhësor.<sup>859</sup>

Pas botimit të "*Mesharit*" interesimi për përkthimin dhe botimin e teksteve liturgjike në gjuhën shqipe vazhdoi edhe më tutje. Kjo dëshmohet me shfaqjen e veprës "*E msuamë e krishterë*" të Lekë Matrangës, e botuar më 1592. Lekë Matranga (1560-1619) ishte nga Hora e Arbëreshëve të Sicilisë dhe ishte një nga nxënësit e parë të Shën-Athanasit të Romës. Pos rëndësisë fetare katekizmi "*Em-suamë e krishterë*" e Matrangës, ka edhe vlerë letrare. Sepse, krahas tekstit parësor, autori sjell edhe një poezi me tetë vargje, me të cilën autori fton besimtarët të venë përherë në kishë.

Në të njëjtën kohë në Shqipëri filluan të vinin misionarët katolikë sidomos nxënësit e kolegjit të Loretos, të cilët fillojnë organizimin e shkollave fillore pranë kuvendeve dhe famullive të tyre.<sup>860</sup>

Në vazhden e kësaj veprimtarie, ndër të dalluarit ishte prelati Pjetër Budi (1566-1622), nga Guribardhi i Matit. Budi përktheu dhe botoi, në vitin 1618 "*Doktrinën e Krishterë*" dhe më 1621 në një vëllim të përbashkët "*Pasqyrën e të rrëfyemit*" dhe "*Ritualin roman*". Në veprën e vet, Budi botoi edhe një numër të madh poezish, të gjitha në frymë fetare dhe ku bëhet përpjekje për t'i paraqitur ato në formë artistike.<sup>861</sup>

---

<sup>858</sup> Më gjerësisht rreth "*Mesharit*" të Gjon Buzukut shih botimin komplet të Mesharit, "Rilindja" 1978. Teksti është i transliteruar dhe përcillet nga parathënia e punuar nga profesor Eqrem Çabej. Profesor Çabej, sjell një studim të hollësishëm jo vetëm rreth vlerës dhe rëndësisë gjuhësore të veprës për historikun e gjuhësisë dhe kulturës shqiptare në përgjithësi, por njëherësh zbërthen edhe disa nga rrethanat në të cilat është shkruar vepra, që po ashtu kanë rëndësi të madhe për studimet e më tutjeshme.

<sup>859</sup> "*Meshari i Gjon Buzukut 1555*", Rilindja, Prishtinë, 1978, faqe 7.

<sup>860</sup> "*Historia e Popullit shqiptar*", I, Prishtinë, 1969, faqe 350.

<sup>861</sup> Po aty, faqe 350.

Do të shihet se edhe përkundër kësaj veprimtarie si dhe fillimit të qarkullimit të veprave të para fetare në gjuhën shqipe, në saje të depërtimit të fuqishëm të islamit në viset shqiptare, gjendja e kishës katolike dhe e besimtarëve të saj edhe më tutje shfaqej me vështirësi të shumta dhe nga dita në ditë hapësira i rrudhej. Që të bëjë diç drejt parandalimit të kësaj gjendje, nga viti 1662 e këndej Vatikanit vendosi që propagandën fetare në vendet e Lindjes t'ia dorëzojë institucionit të fuqishëm, të krijuar prej saj “*Propagandës Fide*” (Për përhapjen e fesë) me qendër në Romë. Instituti i ri ngriti herë pas herë për kuadrat shqiptare edhe shkolla të tjera si “*Kolegjin ilirik*” të Feros (1633) nën drejtimin e misionarëve jezuitë, pastaj “*Shkollën e Montoriso*” në Romë, nën drejtimin e misionarëve françeskanë dhe dy shkolla për nxënësit e ritit unit nën drejtimin e bazilianëve. Më të dalluarit që kryenin këto kolegje ndiqnin pastaj studimet e larta në “*Kolegjin urban të Propagandës*”. Të tillët, pastaj dërgoheshin në Shqipëri si ushtarë të Propagandës Fide, të cilët jo rrallë, nga mungesa e njohurive të gjuhës shqipe dhe rrethanat e rënda në të cilat veprohej, nuk do të jenë në gjendje të kryejnë misionin në përputhje me kërkesat e besimtarëve, që më tepër ishin të natyrës praktike se sa të asaj filozofike.<sup>862</sup>

Disa nga prelatët shqiptarë, siç ishte Pjetër Budi, do t'i shkruajnë Propagandës Fide që të merren parasysh rrethanat e Shqipërisë dhe atje të dërgojnë famullitarë që dinin gjuhën shqipe, gjë që do të krijojë një gjendje të acaruar midis tij dhe Vatikanit sa të hapë dyshimin se mbytja e tij tragjike në lumin Drin, mund të ishte pjesë e një atentati të kurdisur ndaj tij nga çarçet e caktuara të Vatikanit, që nuk lejoni që fryma kombëtare të jetë mbi atë fetare?<sup>863</sup>

Përkundër këtyre shqetësimeve të brendshme, që do ta përcjellin veprimtarinë e misionarëve katolikë në Shqipëri, shfaqja dhe puna e tyre do të sjellë edhe hapjen e shkollave të para fillore në gjuhën shqipe. Shkolla e parë për mësim fetare do të hapet në Kurbin të Krujës, më 1632, ku mësonin 10 nxënës klerikë. Katër vjet më vonë, misionarët françeskanë hapën një shkollë në Pdhinë afër lumit Mat. Një vit më vonë, me kërkesën e banorëve të Blinishtit (Zadrime), françeskanët ngritën një kuvend dhe pranë tij një shkollë të mesme (gymnasium). Në vitin 1671, në Janjevë të Dardanisë, hapet shkolla e parë shqipe.<sup>864</sup>

Shkolla të ngjashme u hapën edhe në Velje të Mirditës dhe në Shkodër. Për nevojat mësimore të këtyre shkollave, përkujdeseshin vetë priftërinjtë Shqiptarë që ishin njëkohësisht edhe mësues. Ata përgatisnin tekstet përkatëse në gjuhën shqipe.

---

<sup>862</sup> Bartl, Peter: “*Albanien. Von Mittelalter bis Gegenwart*”, Regensburg 1995.

<sup>863</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, I, Prishtinë 1969, faqe 351.

<sup>864</sup> Shih Gjini, Gaspër: “*Skopsko Prizrenska Biskupija kroz stoljeća*”, Zagreb, 1986.

Shumë prej tyre qenë tekste fetare, si ata që u përkthyen dhe u botuan prej Pjetër Budit, ose vepra origjinale si ajo me titull “*Çeta e Profetëve*”, e shkruar nga Pjetër Bogdani (1625-1689)<sup>865</sup>.

Disa nga këto vepra kishin krejtësisht karakter mësimor-didaktik. Të tilla qenë “*Fjalori latinisht-epirotisht*” i Frang Bardhit (1606-1643), që u botua më 1635, si dhe “*Gramatika latinisht-shqip*” që kishte përgatitur Andrea Bogdani, dorëshkrimi i së cilës humbi gjatë ekspeditave turke të vitit 1683 bashkë me disa tekste të tjera fetare dhe fjalorë që u përdorën në dorëshkrim dhe humbën më vonë.<sup>866</sup>

Përhapja dhe ngritja e shkollave shqipe nëpër kuvende të kishave bashkë me botimin e veprave të përkthyera në gjuhën shqipe me tekste të zgjedhura liturgjike, fillimisht për nevojat e klerit katolik shqiptar, por që më vonë në to do të pasqyrohen edhe pjesë të krijimitarisë artistike dhe me këtë do t’i vihen themelet letërsisë së vjetër shqipe, do të shqetësojë autoritetet zyrtare osmane, të cilët do të marrin masa që këto shkolla të pengohen ose të mbyllën fare. Nga represioni disa prej tyre do të ndërrojnë objektet dhe vendet, por jo edhe veprimtarinë. Priftërinjtë shqiptarë do t’ia dalin që disa nga shkollat t’i organizojnë nëpër kuvende ani pse jo rrallë nga klerikët e kishës ortodokse serbe do të denoncohen tek autoritetet zyrtare osmane.<sup>867</sup>

Që të ruhet fryma e angazhimit edhe kundruall këtyre rrethanave të vështirësuar, papa Klementi XI, me origjinë shqiptare, mori masa të shumta që t’u vijë në ndihmë klerikëve katolikë në Shqipëri. Kështu, më 1703, me nxitjen dhe me ndihmën e papës u mbledh koncili i peshkopëve të Shqipërisë që njihet me emrin “*Koncili i Arbënit*”. Krahas vendimeve për çështje ngushtësisht fetare, Koncili mori edhe vendime për përhapjen e letërsisë fetare në gjuhën shqipe. Më 1711, me nismën e papës Klementi XI, në shkollën e Montorios në Romë u krijua edhe Katedra e Gjuhës Shqipe.<sup>868</sup> Hapja e Katedrës së Gjuhës Shqipe në Romë, të cilës do t’i paraprijnë edhe veprimtaria e “*Kolegjit Ilirik*” të “*Propagandës Fide*” dhe atij të “*Shën-Athanasit*” nga urdhri unit bazit, do të krijojë një fundament shpirtëror, kulturor dhe shoqëror për ruajtjen e trashëgimisë perëndimore të Shqiptarët si dhe për thellimin e saj të mëtutjeshëm edhe në ato rrethana të rënda të hapjes së islamit ndër Shqiptarë.

---

<sup>865</sup> “*Çeta e Profetëve*” e Pjetër Bogdanit vlerësohet ndër veprat themelore të letërsisë klasike shqiptare. Sepse, në të, krahas teksteve fetare, trajton edhe çështje të filozofisë, po herë pas here, vëmendje u kushtohet edhe çështjeve shoqërore dhe atyre historike të kohës. Në këtë vepër kanë gjetur vend edhe shumë tekste letrare – krijime origjinale të autorit, të shkruara me një gjuhë të pastër, stil të rrjedhshëm që atë e ngrëhin në nivelin e një vepre me karakter letrar dhe artistik. Vjershat “*Sibilat*” shfaqen si poezitë e para lirike në letërsinë shqipe.

<sup>866</sup> “*Historia e popullit shqiptar*”, I, Prishtinë, 1969, faqe 352,

<sup>867</sup> Gjini, Gaspër: “*Skopsko Prizrenska Biskupija kroz stoljeća*”, Zagreb, 1986.

<sup>868</sup> “*Historia e popullit shqiptar*”, I, Prishtinë, 1969, faqe 353.



Në luftë që kjo vetëdije të merrte përmasat e një kthese shoqërore e cila do të pasqyrohet edhe me projektet për kundërvënie të hapur ndaj pushtimit osman, nuk është e rastësishme që disa nga përfaqësuesit më të ndërgjegjshëm të klerit katolik shqiptar, Pjetër Budi dhe Pjetër Bogdani, drejtpërdrejt do të angazhohen në këtë veprimtari. I pari duke kërkuar një kryengritje të armatosur të malësorëve shqiptarë të veriut, të cilëve do t'u printe një kalorës perëndimor. Dhe, i dyti - duke u angazhuar drejtpërdrejt në luftën austro-turke në anën e gjeneralit të Vjenës, Pikolomeni, i cili me ushtrinë e tij kishte depërtuar deri në Prishtinë dhe Shkup duke ua rikthyer shpresën popullatës krishtere se Osmanëve mund t'u kishte ardhur fundi.

Pjetër Budi, pra, kërkonte prijësin nga jashtë, si udhëheqës dhe shpëtimtar i Shqiptarëve, ndërsa Pjetër Bogdani do t'i bashkëngjitet atij që tashmë në saje të luftës kundër Osmanëve, ia kishte dalë që të korrite një fitore, të ngjashme me atë të Skënderbeut para më shumë se dy shekujsh. Edhe pse në një rën anë projekti i Budit rreth kryengritjes së armatosur me një prijës europian, do të mbetet vetëm kërkesë, (që do t'i kushtojë me kokë), dhe në tjetrën anë edhe angazhimi i drejtpërdrejtë i Bogdanit me besimtarët e vet përkrah Pikolominit do të dështojë, dhe kjo do të ketë pasoja të rënda për popullatën shqiptare. Megjithatë, veprimet e tyre do të tregojnë se kthesat historike janë të mundshme dhe ato shfaqen vetëm atëherë kur proceseve u prijnë intelektualët si shtresë e ndërgjegjshme e një shoqërie.

## LUFTËRAT AUSTRO-OSMANE DHE ROLI I SHQIPTARËVE NË TO

“Motit i madh” Shqiptarëve do t'ua ushqejë kujtimin e një lavdie, siç ishte ajo e fitoreve që korren gjatë luftërave që bënë nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit Skënderbeut, por njëherësh ua bëri me dije gjendjen e rëndë në të cilën do të katan disen më pastaj ndaj së cilës megjithatë duhej reaguuar që robëria të mos kthehej në një gjendje të përhershme. Dhe, të dhënat e shumta tregojnë se Shqiptarët edhe pas vdekjes së Skënderbeut, pa marrë parasysh terrorin e ushtruar mbi ta, pa marrë parasysh pasojat e rënda të shtypjes me të cilat do të ballafaqohen, dhe pa marrë parasysh sehirin që u vinte nga vendet e krishtera perëndimore, së paku sa i përket gjysmës së parë të shekullit nën zgjedhën osmane, do të gjejnë forcë që të kundërshtojnë dhe madje edhe të organizojnë kryengritje, të cilat do t'u qesin telashe të shumta ushtarakëve të lartë të Portës. Për t'i shuar ato ekspeditave të fuqishme ndonjëherë do t'u prijnë edhe sulltanët, siç ishte ajo e vitit 1492 kundër himarjotëve që u drejtua nga Bajaziti II, që për “sukses” kishte marrëveshjen me hi-

marjotët me të cilën atyre iu garantua autonomi e gjerë lokale e quajtur “venoma”<sup>869</sup>.

Me kalimin e kohës, kur nga dita në ditë do të bjerë lidhja e brendshme e qëndresës së princave Shqiptarë, aleatë të Skënderbeut, Vatikani dhe vendet perëndimore, të cilat kishin interes që Shqiptarët edhe më tutje t'i mbanin të lidhur për vete ushtritë osmane në mënyrë që ato të mos kishin gjithaq kohë t'i ktheheshin Perëndimit, siç do të ndodhë kur pas ripushtimit të Shqipërisë nuk do të vonojnë dhe forcat osmane për pak do të zbarkojnë në brigjet e jugut të Italisë dhe do t'u drejtohen madje edhe atyre të Spanjës, do të kërkojnë që kjo të bëhet me nxitjen e kryengritjeve shqiptare në pjesë të ndryshme të vendit. Do të shihet se nga gjysma e parë e shekullit XVI e tutje, kur i biri i Skënderbeut, Gjergji i Parë, dështoi që të forcojë pushtetin në jug të Shqipërisë, dhe kjo do të ndodhë në sajë të dredhisë së venedikasve, të cilët në njërin anë do të trimërojnë Shqiptarët që kishin gjetur strehim në Itali për të zbarkuar në Shqipëri dhe në tjetrën anë forcimin e tyre do ta pengojnë me anën e lidhjes së një marrëveshje paqeje me Portën. Sipas marrëveshjes do të fitojnë Korfuzin dhe do të mbajnë Ulqinin dhe Tivarin, energjia dhe disponimi antiosman i Shqiptarëve do të drejtohet jo të çlirohet vendi prej tyre, por për arritjen e parandalimit të vendosjes së plotë të regjimit osman në vend, sidomos të atij timar, ose për të fituar qeverisje lokale (autonomi), në mënyrë që me anën e tyre të ruhen format e shoqërisë patriarkale dhe fisnore të drejtuara nga kanuni mesjetar dhe kodet e tij të njohura, me të cilat Shqiptarët për shekuj ishin vetëqeverisur dhe një pjesë e tyre këtë do ta ruajnë gjatë gjithë kohës sa zgjat pushtimi osman në Shqipëri. Vatikani kishte bindjen se katolicizmi kishte mundësi mbijetimi vetëm në rrethanat e konstrakteve të tilla autonome, të cilat rëndom shfaqeshin në pjesët malore (në Veri dhe Verilindje të Shqipërisë dhe në Jug), ndërkohë që Venediku shihte hesapin që me anën e “oazave” shqiptare jashtë ligjeve osmane, Portën ta mbante të lidhur për marrëveshjet me anën e të cilave republika e Adriatikut ruante mbikëqyrjen mbi disa qytete bregdetare shqiptare, të një natyre tejet strategjike për të.

Këto ecuri, ndonëse korresponduan me njëra-tjetrën sa u përket mjeteve, megjithatë ndiqnin qëllime të ndryshme. Sepse, Selia e Shenjtë, te hapësirat autonome shqiptare shihte ruajtjen e faktorit që forcon frymën dhe përcaktimin shpirtëror të Shqiptarëve kah Perëndimi dhe me të ruhej prania e katolicizmit në këtë nyje të rëndësishme të puqjeve Perëndim-Lindje. Ndërsa, Venediku shihte përdorimin e

---

<sup>869</sup> Po aty, faqe 297.

tij për ruajtjen e interesave të veta ekonomike dhe politike në raport me Perandorinë Osmane, qoftë edhe duke i kthyer në monedhë kusuritjeje siç kishte vepruar edhe gjatë kohës së Skënderbeut pa ngurruar që luftën e tij ta shfrytëzonte në këtë drejtim.

I kësaj natyre gjithsesi ishte edhe qëndrimi i Venedikut ndaj përpjekjeve të disa vendeve europiane që në Shqipëri, në verën e vitit 1594, të fillonin një kryengritje të madhe kundër Osmanëve, në të cilën, krahas Shqiptarëve do të merrnin pjesë edhe të krishterët tjerë nga radhët e Serbëve, Bullgarëve, Grekëve dhe Boshnjakët. Shumë nga krerët Shqiptarë, në një kuvend të Matit, do të pajtohen me një kryengritje, e cila do të “bekohej” nga papati dhe do të ndihmohej nga vendet e tjera të krishtera. Bëhet e ditur se kalorësit, Tomë Plezha dhe Mark Gjini, që ishin në shërbim të Venedikut, bashkë me peshkopin Nikollë Mekajshi, hynë në bisedime me papatin<sup>870</sup>.

Por, Venediku, do të përdorë intrigat e njohura që kjo përpjekje të dështojë, siç do të dështojë edhe ajo që në një kuvend i njëjtë në Mat do të përsëritet pas dy vjetësh kur të njëjtit përfaqësues Shqiptarë do të paraqiten në Romë me kërkesë për ndihmë dhe do të kthehen duarthatë, meqë Venediku do të bindë papën se duhej pritur përderisa të vazhdonte lufta e Hungarezëve me Osmanët, e cila për Perëndimin duhej të kishte përparësi krahasuar me atë të Shqiptarëve, e cila nuk i kishte gjasat për ndonjë sukses të madh.<sup>871</sup>

Përgjigje të ngjashme morën edhe disa nisma të tjera të kuvendeve vendore shqiptare, siç ishte ajo e kuvendit të Dukagjinit në Mat, në vitin 1602, kur përfaqësuesit e tyre, Nikollë Bardhi – peshkop i Sapës dhe Pal Dukagjini – kapedan i Venedikut shkojnë në Venedik për ndihmë dhe atje do t’u thuhet se “nuk kishte ardhur koha për luftë të përgjithshme kundër Turqve”. Madje, të kota qenë zotimet e përfaqësuesve të Dukagjinit se nëse Venediku do t’i ndihmonte me armë në një luftë që do të përfshinte rreth 100 mijë burra të zgjedhur shqiptarë, ata jo vetëm që do t’ia dorëzonin Krujën Venedikut, por së bashku do t’i drejtoheshin edhe Kostandinopojës.<sup>872</sup>

---

<sup>870</sup> Më gjerësisht rreth veprimtarisë së Tomë Plezhës, Mark Gjinit dhe të peshkopit Nikollë Mejkashi në relacionet Romë- Venedik shih Zamputi I. Në “*Dokumente të shekujve XV-XVI për historinë e Shqipërisë*”, I, Tiranë 1989.

<sup>871</sup> “*Historia e popullit shqiptar*”, I, Prishtinë 1969, faqe 335.

<sup>872</sup> Kuvendi i Dukagjinit u mbajt në Kishën e Shën Aleksandërit në Dukagjin më 15 shkurt 1602. U mbledhën 2656 veta, përfaqësues të mjaft krahinave shqiptare, kryesisht pleq të krahinave të Veriut si dhe klerikë katolikë në këto anë, ndër të cilët duhet dalluar peshkopin e Sapës, Nikollë Bardhi dhe Pal Dukagjini si kapedan në shërbim të Republikës së Venedikut. Aty kishte përfaqësues edhe nga Kruja, Shkodra,

Duarthatë do të kthehen përfaqësuesit e Dukagjinit edhe nga vizita që ia bënë Romës, ku shfaqën të njëjtat kërkesa, pra që të ndihmoheshin për një kryengritje të madhe kundër Osmanëve. Në Romë, madje, ata u priten me njëfarë mosbesimi, ngaqë konsideroheshin se ishin në shërbim të Venedikut që edhe Papati të përfshihej në intrigat e tyre të njohura me anën e të cilave nuk ndiqeshin interesat e një kryengritje antiosmane në tokat shqiptare dhe në përgjithësi përtej Adriatikut, por ato venedikase, ku ata duhej të ruanin praninë e tyre “të veçantë” në ato pjesëgjithnjë në marrëveshje të fshehta me Osmanët.<sup>873</sup>

Përballë këtyre rrethanave kur nga gatishmëria e Shqiptarëve për t’iu kundërvënë Osmanëve kërkohej kusuritje, faktori i ndërgjegjshëm brenda klerit katolik shqiptar, kërkoi që strategjia venedikase e përdorimit të Shqiptarëve për nevojat e veta, të ndryshojë dhe forma e ruajtjes së vetëqeverisjes lokale dhe e autonomive të mbikëqyrura, siç do ta gëzojnë Malësia e Madhe, ajo e Dukagjinit, e Matit, e Mirëditës dhe një pjesë e Malësisë së Gjakovës, të kthehen në hapësira nxitëse për kryengritje gjithëpopullore, meqë ashtu mendohej se nxitja e një lufte me Osmanët dhe sukseset e saj nismëtare do të ndërlihdnin pashmangshëm edhe vendet e krishtera europiane për të.

Kështu, në dhjetëvitëshin e dytë të shekullit të shtatëmbëdhjetë prelati shqiptar, Pjetër Budi<sup>874</sup>, pasi që të dështojnë disa nisma të kuvendeve shqiptare siç ishte ai i Matit dhe të Dukagjinit dhe ato me karakter ballkanik (kuvendet e Kuçit, të Prokupës dhe Beogradit) si dhe një varg nismash të misionarëve dhe kapedanëve të ndryshëm nga Perëndimi, do të angazhohet me të madhe, për një luftë me Osmanët. Pjetër Budi do të bëjë edhe projekte për kryengritje dhe ato do t’ua dërgojë Vatikanit e disa vendeve të tjera europiane me zotimin se do të bëheshin nga Shqiptarët e besimit të krishterë dhe ata që kishin pranuar islamin pa munguar edhe aspektet ushtarake të paraqitura në hollësi dhe mjaft bindëse. Kjo len për të kuptuar se ato mund të jenë bërë në bashkëpunim të ngushtë edhe me strategë lufte, të cilët nuk mungonin në këto anë. Në vitin 1616 me planet e shkoqitura deri në hollësi Budi shkoi në Romë, me shpresën që atje të gjente mbështetje, ku nga

---

Elbasani, Durrësi, Myzeqeja, Kosova dhe Shpati. (Shih Thëngjilli, Petrika “*Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit 1506-1750*”, Tiranë 2003, faqe 150-153).

<sup>873</sup> Po aty, faqe 154.

<sup>874</sup> Pjetër Budi u lind në Gur të Bardhë të Matit. Për vite të tëra qëndroi në shërbim të disa peshkopatave dhe në moshën 21 vjeçare u bë meshtar në Kosovë, ku qëndroi 12 vjet. Sinodi e ngarkoi me detyrën e vikarit të përgjithshëm. Pas ushtrimit të kësaj detyre për 17 vjet u bë peshkop i Sapës. Gjatë shërbimit të gjatë, ai ishte ngarkuar disa herë nga popullsia shqiptare që të përfaqësonte kërkesat e Shqiptarëve në Romë. Budi, gjatë punës si meshtar, u mor edhe me përkthimin e veprave liturgjike në gjuhën shqipe siç janë “*Doktrina e krishtenë*”, “*Pasqyra e të rrëfyerit*” dhe “*Rituali roman*”.

Vatikan i krahas mjeteve të duhura, të kërkonte që vendet europiane t'i furnizojnë Shqiptarët me armë dhe kuadro ushtarake që ata të shfaqeshin sa më të përgatitur për një luftë me Osmanët në të cilën do të përfshiheshin edhe të tjerët. Budi kishte shpresën se do ta takonte Papën Pali V ose ndonjë kardinal tjetër në Romë. Kjo nuk i shkoi përdore, ngaqë ishte shumë e qartë se Selia e Shenjtë, përkundër trimërimin të Shqiptarëve që të hidheshin në kryengritje, nuk dëshironte të merrte përsipër rolin e nxitësit të drejtpërdrejtë të një lufte me Osmanët. Budi, madje, nuk mundi ta takonte as kalorësin Betruçi, i cili ndodhej në Gjermani me detyrën që prej andej të organizonte vullnetarë për një luftë me Osmanët.<sup>875</sup>

Pas pesë vitesh, Budi prapë do të shihet të qëndrojë në Romë me të njëjtin mision. Me këtë rast, kardinalit Gocadino do t'ia dorëzojë planet e luftës dhe kërkesën që asaj t'i prijë kalorësi boshnjak Bertuçi, i cili kishte shprehur gatishmërinë për këtë luftë dhe madje thuhej se kishte marrë edhe pëlqimin e disa vendeve europiane të interesuara për të, siç ishin Gjermania dhe Austria.<sup>876</sup>

Planet e Budit për t'u ndihmuar një luftë e përgjithshme kundër Osmanëve nuk do të përkraken. Venediku sërisht futi gishtat aty dhe papati nuk e dha dritën e gjelbër për një kryengritje të madhe shqiptare me karakter ballkanik, meqë në ato rrethana nuk kishte interes për diç të tillë.

I dëshpëruar nga refuzimi dhe me bindjen se kësaj mund t'i kenë ndihmuar një pjesë e klerit katolik dhe misionarët që ai i shihte në shërbim të Venedikut dhe lojërave të njohura që bënte, Pjetër Budi kthehet në Shqipëri, ku në fillim të vitit 1622 mblodhi në një kuvend të posaçëm klerin katolik të tri dioqezave (Zadrimës, Shkodrës dhe Lezhës) dhe i bindi që të mos pranonin asnjë peshkop të huaj në këto dioqeza. Dhe, në qoftë se do të dërgohej ndonjë i tillë, të dëbohej që këtej nën pretekstet se këta nuk njihnin as gjuhën e as zakonet e vendit. Ishte ky një qëndrim rebelues i prelatit shqiptar, që kapërcente kornizat e sjelljes së rëndomtë. Pas dhjetë muajsh, Pjetër Budi, gjatë udhëtimit për në Malësinë e madhe, u mbyt nga armiqët e tij, kur po kalonte lumin Drin.<sup>877</sup>

Mbytja e prelatit shqiptar Pjetër Budi në lumin Drin bashkë me disa dokumente të rëndësishme që i mbante bëri, me të drejtë, të dyshohet se ishin të një natyre të rëndësishme për historinë e Shqiptarëve (meqë dihet se ai merrej me hulumtime nëpër arkivat e Vatikanit dhe me aso arkeologjike në Shqipëri), gjë që të flet edhe për druajtjen që kishte Selia e Shenjtë ndaj përzierjes “jashtë mase” të

---

<sup>875</sup> Thëngjilli, Petrika: “*Shqiptarët midis lindjes dhe perëndimit*”, Tiranë 2003, faqe 220.

<sup>876</sup> Zamputi, I: “*Dokumente...*”, vëllimi III, faqe 376-377.

<sup>877</sup> “*Historia e popullit shqiptar*”, vëllim I, Prishtinë, 1969, faqe 341.

klerit katolik shqiptar në çështjet shoqërore dhe ato politike, me të cilat mund të prekeshin raportet e caktuara dhe marrëveshjet e papatit me Portën e Lartë. Si do të shihet, pas Reformacionit e këndej, Vatikani tregoi interes për gjendjen e klerit katolik në Ballkan, por po ashtu përkujdesej që të mos lejohej që fryma e protestantizmit në veri, në hapësirat e pushtuara prej Osmanëve, kishës katolike t'i japë karakter nacional, qoftë edhe kur është fjala për mbijetimin e saj. Këtë më së miri do ta tregojë letra e Domenik Andreait, e shkurtit 1623 drejtuar kardinalit Barberino, i cili hulumtonte rastin e Pjetër Budit, ku pos të tjerash, do të thotë për prelatin shqiptar “se kishte mëkate” dhe se ato mëkate lidheshin me atë “se kishte kërkuar që priftërinjtë që dërgoheshin në Shqipëri të dinë gjuhën shqipe”, gjë që kjo nuk duhet lejuar, por duhet vazhduar praktika e dërgimit të peshkopëve, të huaj, pra nga jashtë.<sup>878</sup>

Letra që Pjetër Budi ia dërgoi kardinalit Gocadino me rastin e qëndrimit të dytë në Romë, ku ai edhe më tutje kërkonte luftën e Shqiptarëve me Osmanët në të cilën do të përfshiheshin vendet europiane, sigurisht se zbulon ca nga arsyet pse prelati i njohur shqiptar, autor i “*Doktrinës krishtene*”, i “*Pasqyrës së të rrëfyemit*” dhe i “*Ritualit roman*” shfaqej i rrezikshëm jo vetëm për regjimin osman, por për më tepër edhe për linjën unitariste të klerit katolik, që ndalonte çfarëdo ngjyrosje të klerit me përkatësinë nacionale, dhe veçmas për Venedikun, i cili ishte i interesuar që Shqiptarët dhe fuqinë e tyre t'i shfrytëzonte për hesapet e veta dhe assesi që ata të shfaqeshin si faktorë më vete.

Mbytja e prelatit shqiptar, Pjetër Budi, në lumin Drin mori me vete edhe një pjesë të vrullit kundërosman të Shqiptarëve, veçmas të atyre të besimit katolik, të

---

<sup>878</sup> Shih letrën që Domenik Andreasi do t'ia dërgojë hetuesit Barberino, cituar sipas Iniac Zamputit nga “Dokumente...”, vëllimi III.

*„Pas një udhëtimi kaq të mundimshëm nga kohë shumë të këqia, qoftë për tokë qoftë për det, arrita dioçezën... Dhe po marr vesh se qenka e vërtetë ajo që më kanë tregue disa njerëz të denjë me u besue se ipeshkvi i Zadrimës, kur arriti në ipeshkvinë e vet bani një mbledhje me klerin ku ka thanë se tash e mbrapa mos me u pranue ipeshkvinj as abatë në ato anë në mos qofshin vendas dhe i ka bamun të gjithë priftërinjtë ta nënshkruejnë kërkesën dhe kështu ka veprue kundër lirisë kishtare...*

*Asgjëmangut, me keqardhje e me idhnimin tim të pamasë mora vesh se mbasi udhëtonte, nuk ka shumë kohë, tue e kalue një lumë (qi quhet Drin), me pesë vetë u mbyt sigurisht në mënyrë të mjerë... As nuk ka qenë e mundun të gjendet trupi i tij. Zoti të ketë mëshirë për atë shpirt. Ai ka ba edhe faje të tjera...*

*Prandaj, zotmijë të përndritshëm, ju lutem, së bashku me të përndritshmin kardinal, mos lejoni të zgjidhen ipeshkvinjë trashamanë, sepse lindin gabime të tilla edhe më të randa...*

*Andaj asht e nevojshme qi këtu ipeshkvinjtë edhe matutje me u ba të huajt, sikurse ka qenë me të shumtën zakoni...“*

cilët kërkonin që Shqipëria të kthehej në një log lufte kundër tyre, por jo edhe fuqinë e tij të brendshme, e cila do të vihet në veprim sa herë që t'i jepej rasti. Gjysmë shekulli më vonë, do të jetë lufta austro-turke, e cila një pjesë të mirë të Shqiptarëve e përfshiu në anën e vet, kur ata do t'i bashkohen asaj sapo ajo të arrijë hapësirën e tyre.

Para se të ndodhin këto luftëra, janë ato veneto-osmane të viteve 1638-1715, në të cilat do të përfshihen edhe Shqiptarët, të cilët, në përpjekjet e tyre për t'u shkëputur nga pushtimi osman, ose që të ruanin vetëqeverisjen vendore pa iu nënshtruar sistemit të timarit, edhe më tutje kishin nevojë për përkrahës nga jashtë. Natyrisht se në këto rrethana, përpjekjet e Shqiptarëve që të kundërshtonin pushuesit si dhe gatishmëria e tyre që nga krahinat e lira malore, ku ata ruanin vetëqeverisjen, të mobilizonin forca të caktuara për veprime luftarake, ishin në shënjestër të Venedikut, i cili, kërkonte përfitime prej tyre. Rast për një veprim të tillë ishte lufta e Kretës, e cila zgjati thuhet një çerek shekulli (1644-1669) dhe përfundoi me fitoren e Osmanëve, ngjarje kjo që do t'u japë një shtysë të mëtutjeshme proceseve të islamizimit të popullatës shqiptare. Fillimisht duke parë se ofensiva e Osmanëve ishte e pandalshme dhe mund të çonte te humbja e shpejtë e ishullit, venedikasit kryekrejtë iu kthyen faktorit shqiptarë, duke përfshirë sa më shumë vullnetarë në ushtrinë venedikase dhe duke i nxitur krahinat e ndryshme shqiptare në rebelim antiosman, në mënyrë që ushtria osmane të shpërqendrohej nga Kreta për te viset shqiptare.

Kështu, Republika e Venedikut, sapo nisi lufta osmane për Kretën hodhi shikimin nga Shqiptarët, duke i nxitur për kryengritje. Por, Shqiptarët, që kishin një përvojë jo të mirë me Venedikun dhe lojërat e tij, nuk u treguan gjithaq të gatshëm për ndonjë veprim që do t'u shkonte për shtati atyre. Disa klerikë katolikë, të cilët ishin të lidhur me Venedikun, filluan të vepronin drejt një lëvizjeje me anën e të cilës një pjesë e territoreve shqiptare të vihej nën juridiksionin e Venedikut. Me këtë rast u thurën edhe plane konkrete për një kryengritje të përgjithshme, por ato ranë në ujë ngaqë Osmanët u ranë në fije dhe morën veprime të rrepta ndaj klerikëve katolikë dhe disa veprimtarëve. Me këtë rast, bëhet e ditur se për t'i shpëtuar hakmarrjes osmane, shumë nga Shqiptarët e krishterë pranuan islamimin.<sup>879</sup>

Megjithatë, futja e ushtrisë venedikase në luftë kundër ushtrisë osmane (1647) për ta mbrojtur Kretën, u përcoll me një fushatë tjetër nga ana e klerit katolik ndërsa Shqiptarët se përfshirja e tyre në këtë luftë, për të cilën propagandohej se do t'u

---

<sup>879</sup> Më gjerësisht shih: Hecquard, H : "*Historie et description de la Haute Albanie ou Guegarie*", Paris 1858, faqe 472; Jaques, E: "*Shqiptarët*", Tiranë, faqe 357.

takonte Venedikasve, do të krijonte mundësi për heqjen e pushtesit osmanë. Duke parë disponimin e disa krahinave të pavarura shqiptare që të përforcoheshin, Venediku futi armatime të shumta në ato anë bashkë me ushtarakë të maskuar, të cilët filluan organizimin e njërive shqiptare që do të hidheshin në kryengritje kundër forcave osmane. Peshkopi i Durrësit Mark Skurra ishte ndër zëdhënësit kryesor të kryengritjes shqiptare, i cili njoftonte Selinë e Shenjtë se “Mbretëria e Shqipërisë gjendej në kryengritje shumë të mëdha për mbrojtjen kundër Turqve”.<sup>880</sup>

Edhe kjo kryengritje, pati fatin e të ngjashmeve që aso kohë bëheshin të shumtën në përputhje me interesat e Venedikut, që rëndom përfundonin me marrëveshje me Osmanët, ndërkohë që Shqiptarëve u mbetej ndëshkimi i ashpër ose mundësia e kthimit në islam – si shpëtim. Edhe pse kjo lëvizje kryengritëse nën drejtimin e Mark Skurës thuhet se mbledhi rreth shtatë mijë kryengritës dhe pos sulmit ndaj kështjellës së Shkodrës dhe Podgoricës u përhap në disa pjesë të Shqipërisë – deri në Himarë, ajo u shua shpejt, ngaqë Venediku jo vetëm që nuk dërgoi ushtritë e tij, siç premtoi, por ndërpreu edhe furnizimin me armë, gjë që kryengritësit mbetën në gjysmë të rrugës, të përballur me furinë osmane.<sup>881</sup>

Këto humbje bënë që për disa vjet të mos ketë kryengritje në viset shqiptare si dhe në pjesët që mbaheshin të mbikëqyrura nga Venediku. Por, disfata osmane në dyert e Vjenës (12 shkurt 1683), jo vetëm që ktheu fatet e luftës në anë të kundërt, pra nga Osmanët te vendet e krishtera europiane, por ajo te popujt e robëruar të juglindjes europiane (Sllavët, Shqiptarët, Grekët) serish ndezi shpresat e çlirimit. Shkas i mirë për këtë rizgjim ishte edhe krijimi i “Lidhjes së Shenjtë” më 1684, koalicion ky në të cilin merrnin pjesë Austria, Polonia, Venediku, Malta dhe, mbas dy vjetësh, edhe Rusia.<sup>882</sup>

Natyrisht se në këtë koalicion e forcuar pas fitores së Vjenës, Austria, tashmë shfaqej bartëse e fushatës së re me të cilën duhej të shkatërrohej një herë e mirë forca osmane në pjesën qendrore të Ilirikut, pikërisht aty ku sllavët në veri dhe Arbërit në jug përbënin dy shtyllat kryesore që duhej rikthyer. Duke ditur këtë fakt, perandori i Austrisë, Leopoldi I, qysh në vitin 1687 lëshoi një thirrje këtyre popujve që t’i bashkohen luftë së “Lidhjes së Shenjtë”.

Pse Arbrit e besimit katolik do t’i bashkohen, në masë të madhe, thirrjes së perandorit të Austrisë, Leopoldit I, së pari ka të bëjë me të drejtën e mbrojtjes së

---

<sup>880</sup> Shih Zamputi Injac: “*Relacione...*”, vëll. II, faqe 374.

<sup>881</sup> “*Historia e Shqipërisë*”, vëll. I, Tiranë 1965, faqe 369.

<sup>882</sup> Shih Jaques, E: “*Shqiptarët*”, Tiranë, faqe 357-358; Thënxhilli, Petrika: “*Historia e Perandorisë Osmane*”, Tiranë, faqe 178.



besimtarëve katolikë në shtetin osman, që perandoria e Austrisë e kishte fituar qysh në vitet 1615-1616 dhe së dyti lidhet me premtimin që Leopoldi I u bënte popujve të krishterë të Ilirikut, ndër ta edhe Arbërve, se në rast fitoreje do t'u garantoheshin të drejtat vetëqeverisëse, liritë e fesë bashkë me privilegje dhe të drejtat e tjera që lidheshin edhe me shprehjen dhe kultivimin e identitetit nacional, nga gjuha e deri te flamuri.<sup>883</sup>

Faktori i parë, pra që ka të bëjë me të drejtën e Austrisë për t'i mbrojtur besimtarët katolikë në hapësirën europiane të Perandorisë Osmane, për nga efektet që do të sjellë, po ashtu mund të vlerësohet nga dy aspekte: nga ai pozitiv - sepse popullata e besimit katolik, por jo vetëm ajo, në njëfarë mënyre, merrej në mbrojtje nga pikëpamja shpirtërore dhe kjo kishte rëndësi në rrethanat kur kisha ortodokse sllave dhe ajo greke ushtronin politikë hegjemoniste dhe asimiluese ndaj të krishterëve arbërorë – dhe negativ – sepse kjo do të sjellë rivalitet midis Vjenës dhe Selisë së Shenjtë rreth ndikimit tek Arbërorët, fillimisht në fushën e ruajtjes së primatit ndaj kishës katolike për t'u bartur pastaj në sferën kulturore dhe shoqërore.

Në këto rrethana ishte më se e qartë se kleri katolik shqiptar, i cili tashmë kishte arritur shkallën sa kisha katolike e Arbëri të bëhej sinonim i kishës austriake,<sup>884</sup> do të përkrahte nismën e perandorit të Austrisë për luftë të përbashkët kundër Osmanëve. Andaj, ishte edhe e pritshme që sapo ushtritë austriake të arrijnë në Nish dhe, më 24 shtator 1689, të udhëhequra nga konti Ludovig dhe atje të fitojnë betejën e Nishit, Arbrit të deklarohen në favor të austriakëve dhe ishin gati të pranonin mbrojtjen e perandorit austriak. Kështu, pasi që ushtria austriake të Nishi do të ndahet në dy drejtime: njëra pjesë kah Vidini (Bullgari) e udhëhequr nga konti i Badenit dhe tjetra në drejtim të Dardanisë, e udhëhequr nga gjenerali Pikolomini, klerikët katolikë fillojnë fushatën për të pritur dhe për t'iu bashkuar gjeneralit të Vjenës.

Sipas burimeve të kohës,<sup>885</sup> më gjashtë shtator, në Prishtinë, besimtarët katolikë nuk do ta presin Pikolominin vetëm me përshëndetje të thjeshtë, por të udhë-

---

<sup>883</sup> Rizaj, Skënder: “Kosova dhe Shqiptarët dje, sot dhe nesër”, Prishtinë 1992.

<sup>884</sup> Yulcel, Y – Sevim, A : “Turkiye Tarihi”, dok.3, faqe 362.

<sup>885</sup> Rreth luftërave austriake-osmane të viteve 1683-1735 dhe të pjesëmarrjes së Shqiptarëve në to kanë dalë në pah shumë burime, që mbështeten në relacionet e prelatëve Shqiptarë si dhe në raportet ushtarake dhe diplomatike të Vjenës. Historianët shqiptarë I. Zamputi, S. Rizaj dhe S. Pulaha shfaqen më të zellshëm në këtë punë. Por, punës së tyre të përqendruar nga disa aspekte të kësaj problematike i mungon një trajtim kritik gjithëpërfshirës në mënyrë që ajo të mos shfaqet e fragmentarizuar dhe me shpërputhje. Kjo vlen veçmas për ndriçimin se çfarë karakteri kishte ajo në të vërtetë, meqë diku del se në të Shqiptarët e krishterë do të përfshihen në shërbim të saj, diku si forcë kryengritëse, e diku si pjesë e luftës çlirimtare që krahinat me qeverisje autonome do të përpiqen që këtë luftë ta shfrytëzojnë për këtë qëllim dhe të ngjashme. Po ashtu nga dokumentët e komandës austriake Shqiptarët myslimanë thirrën *armautë* kurse të krishterët *albanensen!*

hequr nga peshkopët Pjetër Bogdani dhe Toma Raspasani, me shumë e shumë vullnetarë të krishterë,<sup>886</sup> që tashmë prisnin të hynin nën komandën e tij dhe të vazhdonin më tutje në drejtim të Shkupit luftën kundër Osmanëve.<sup>887</sup>

Me entuziazëm, Pikolomini u prit edhe në Prizren. Banorët e qytetit dhe të rrethinës (mbi 5 mijë) të udhëhequr nga kryepeshkopi Pjetër Bogdani, e pritën edhe me të shtëna pushkësh.<sup>888</sup> Me këtë rast, Pikolomini priti krerët e popullsisë rreth e rrotull, me ç'rast ata i shprehjen vullnetarisht vasalitetin perandorit bashkë me betimin për besnikërinë ndaj tij. Gjenerali kërkoi që popullata t'i lëshonte armët, veç atyre që do t'u lejoheshin nga oficerët gjermanë, pasi që të pranohen ndër regjimentet e rregullta.<sup>889</sup>

Angazhimi i prelatit të lartë Pjetër Bogdani, në anën e austriakëve, nuk mund të vihet në dyshim me asgjë. Në forma të ndryshme këtë e dëshmojnë edhe burimet e shumta, ku ai shfaqet jo vetëm si zyrtar i lartë kishtar por edhe autoritet vendor, i cili ardhjen e ushtrisë austriake si dhe vendosjen e saj, qoftë edhe të përkohshme në viset shqiptare, që pas tërheqjes do të ketë pasoja të rënda për vetë Shqiptarët, e ka cilësuar si çlirim nga dhuna osmane. Megjithatë, mbetet e paqartë sa dhe si ka qenë i përfshirë në vetë drejtimin e luftës. Nga disa burime mund të kuptohet se paraprakisht, në bazë të një marrëveshje me austriakët, ku ka qenë edhe peshkopi i kishës ortodokse, Arsenie III Cernojeviqi, ka marrë zotimin për formimin e një policie shqiptare që do t'u bashkohej trupave austriake dhe të ngjashme, sado që burimet meritore kishtarë këtë nuk e pranojnë dhe kjo është kuptueshme ngaqë kjo u ndalohej klerikëve.<sup>890</sup>

---

<sup>886</sup> Dokumentet ushtarake të kohës njoftojnë se në Prishtinë Pikolomenit iu bashkuan 6000 ushtarë të krishterë (albanensin), por nga disa informata të tjera nga Venediku qëndrimi proaustriak i një pjese të Shqiptarëve vërtetohet me atë që thuhet se "Shqiptarët (arnautë) dhe popujt tjerë të atyre krahinave, turq (myslimanë), si të krishterë, ishin në marrëveshje me gjeneralin Pikolomeni për t'iu nënshtruar mbrojtjes së perandorit austriak" (shih: Zamputi, I – Pulaha, S : "Dokumente...", faqe 226 dhe 293 si dhe Rizaj, S "Kosova..." faqe 56)

<sup>887</sup> Rizaj, Skënder: "Kosova dhe Shqiptarët dje, sot dhe nesër", Prishtinë, 1992, faqe 57.

<sup>888</sup> Nga të dhënat e komandës austriake dhe atyre venedikase përmendet prania e Pjetër Bogdanit si dhe vullnetarëve të tij, numri i të cilëve shkon nga pesë mijë deri në tetë mijë kryengritës nga Kosova. (Shih Rizaj, Skënder "Kosova..." faqe 57-59)

<sup>889</sup> Zamputi, I – Pulaha, S : "Dokumente...", faqe 305-306.

<sup>890</sup> Shih Gjini, Gasper: "Skoposko Prizrenska biskupija kroz stoljeća", Zagreb 1986, faqe 174-175, ku përshkruhet relacioni që Pjetër Bogdani do t'ia dërgojë Kongregacionit nga fundi i vitit 1685, në të cilin bëhet fjalë edhe për luftën austriake-turke si dhe propozimin e besimtarëve të tij katolikë, rreth 300 syresh, që ai t'u prijë ta marrin kështjellën e Novobërdës, por që ai nuk e kishte pranuar me arsyetimin se ishte prelat dhe jo ushtarak. Mospjesëmarrja e Pjetër Bogdanit në aktivitetet luftarake gjatë luftës austriake-turke mund të shihet edhe nga libri i Odette Marquet "Pjetër Bogdani – letra dhe dokumente", Tiranë 1997, në të cilin paraqiten letrat që Bogdani ia ka dërguar "Propagandës Fide". Në këtë libër po ashtu janë edhe disa letra nga Arkivi sekret i Vatikanit. Bogdani flet për pasojat e luftës, sidomos për dhunën që do të ushtrojë njësitë turke, si hakmarrje. Po ashtu flet edhe për ndëshkimin publik që do t'i bëhet në Prizren ditën e tregut nga pashai, por askund nuk bën fjalë për aktivitetet e drejtpërdrejta ushtarake. I nipi ti tij, Gjergj Bogdani, në relacionin që do t'u drejtohet kardinalëve

Por, e dhëna se autoritet osmane do të sillen ndaj tij me shumë ashpërsi dhe nënçmim, qoftë kur në qendër të Prizrenit do ta rrahin publikisht dhe do ta poshtë-rojnë sy botës, qoftë kur pas vdekjes do ta zhvarrosin dhe kufomën do t'ua hedhin qenve, tregon se ai ishte kthyer në një autoritet të rëndësishëm, që duhej rrënuar disi, pa zgjedhur mjetet, gjë që bën të ditur për përkrahjen që tek Shqiptarët gëzonte përkatësia e krishterë dhe qytetërimi perëndimor në përgjithësi, përkundër faktit se një pjesë e tyre kishin pranuar islamin, por që si do të shihet, ai më shumë shfry-tëzohej si mjet për t'i ikur diskriminimit ose për të krijuar privilegje shoqërore se sa që ishte kthyer në bindje shpirtërore.

Sidoqoftë, në njërën anë depërtimi i ushtrisë austriake deri në thellësinë e viseve shqiptare si dhe bashkëngjitja që asaj do t'i bëhet nga një pjesë e madhe e popullatës, jo vetëm e besimit katolik, por edhe e atyre që tashmë kishin pranuar islamin<sup>891</sup>, dhe në tjetrën anë shfaqja e Mustafë Pashë Qypriut, vezirit të fuqi-shëm osman me prejardhje shqiptare, në rolin e rikthimit të hapësirës shqiptare nën zgjedhën e pushtimit osman, në të cilën do të qëndrojë edhe për dy shekujt të tjerë dhe në taborët e të cilit do të marrin pjesë edhe shumë Shqiptarë besnikë të Portës, pos të tjerash, do të hapë një kapitull tragjik të përfshirjes së drejtpërdrejtë të Shqiptarëve në luftën midis Lindjes dhe Perëndimit, qoftë në mbrojtje të civilizimit perëndimor, qoftë për interesa të atij lindor.

Burimet e kohës e dëshmojnë këtë luftë ndërshqiptare mbi baza të përkatësisë fetare, siç dëshmojnë edhe përmasat e mëdha të fatkeqësive me të cilat do të përballen Shqiptarët, qoftë me rastin e depërtimit të Austriakëve, kur njësitë osmane në tërheqje e sipër do të djegin katunde të tëra shqiptare, qoftë kur do të tërhiqen austriakët dhe ata po ashtu do të lënë pas tokën e shkretuar, e cila do të bëhet edhe më e shkretë pasi që turqit të kthehen dhe do të fillojnë të ndëshkojnë bashkëpunëtorët e austriakëve,<sup>892</sup> që për pasojë do të ketë shpërnguljen e një pjese të madhe të

---

ditën e vdekjes së Pjetër Bogdanit, më 6 dhjetor 1689 pranon se Bogdani në Shkup kishte shkuar pranë gjeneralit Pikolomini që t'i inkurajojë ushtarët që luftonin, por atje ishte sëmurë nga murtaja dhe sapo ishte kthyer në Prishtinë kishte vdekur (faqe 509). Se Pjetër Bogdani edhe pa ndonjë pjesëmarrje aktive në luftën austriake-turke, gjë kjo që ishte e arsyeshme kur dihej se një prelati i ndalohej çfarëdo veprimi politik dhe ushtrak, ishte me ndikim, mund të shihet edhe nga letra që nipi i tij, Gjergj Bogdani, misionar në Janjevë dhe Administrator i Prishtinës dhe i Vuçitërnës, i kishte dërguar "Propagandës Fide", më 20 dhjetor 1698, ku ai tregon për kufomën e zhvarrosur të Pjetër Bogdanit nga ana e Turqve, e cila u ishte hedhur qenve deri sa mbante ende mitrën mbi kokë (faqe 516).

<sup>891</sup> Rreth pjesëmarrjes së Shqiptarëve të besimit mysliman në radhët e ushtrisë austriake shih relacionet e shumta të përfshira nga Pulaha, S: "*Qendresa e popullit shqiptar kundër sundimit osman nga shek. XVI deri në fillim të shek. XVIII*" (Dokumente osmane), Tiranë 1978, Zamputi, I – Naçi S – Shkodra, Z: "*Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë*", III, Tiranë 1962.

<sup>892</sup> Gaspër, Gj: "*Skopsko Prizrenska biskupija kroz stoljeća*", Zagreb. Në një relacion të cilin prelati shqiptar nga Gjakova, Gjon Nikollë Kazazi, në viti 1743, do t'ia dërgojë Propagandës Fide, pos të tjerash bëhet fjalë

popullatës shqiptare të besimit të krishterë nga viset veriore, e cila do të largohet bashkë me ushtrinë austriake.

Të dhëna të ndryshme bëjnë të ditur se pas vdekjes së Skënderbeut, luftërat austriake-turke, që me ndërprerje do të zgjasin rreth gjysmë shekulli, etnisë shqiptare në veri dhe verilindje përgjithmonë do t'ia shkëpusin një pjesë të mirë të popullatës, e cila do të drejtohet në veri dhe do të vendoset në pjesët e Austrisë nga Banati, Sremi e deri në Ukrainë.<sup>893</sup>

Për të qenë e keqja edhe më e madhe, gjatë kësaj shpërngulje, Shqiptarët e besimit ortodoks, po edhe një pjesë katoilike, prej nga prejardhjen edhe familja e prijësit të kryengritjes serbe Karagjorgjit dhe asaj mbretërore Karagjorgjeviqëve,<sup>894</sup> të shumtën, do të shkojnë pas patriarkut Arsenie III Cërnojeviq dhe do të trajtohen si popullatë serbe.<sup>895</sup> Skënder Riza thotë se propagandës serbe i ka ndihmuar edhe një keqkuptim që ishte krijuar nga interpretimi i fjalës “serb”, e cila sipas burimeve osmane, serbe, greke dhe ruse ka përfshirë edhe Shqiptarët e besimit ortodoks, ndërkohë që me Shqiptarë (*arnavud, albanese, albana*) janë emërtuar vetëm Shqiptarët e besimit katolik, ndërsa me *turq* Shqiptarët e islamizuar.<sup>896</sup>

Kahas shpërnguljes së parë, e nxitur nga luftërat osmane-austriake të vitit 1689-91, si dhe pasojave të saj të njohura për etninë shqiptare (të krishterë, por edhe myslimane ngaqë u përfshinë në një luftë vëllavërsasëse), me pasoja të ngjashme do të jetë edhe ajo e viteve 1737-9, midis osmanëve dhe austriakëve, që po ashtu për log, të shumtën kishte etninë shqiptare. Në të vërtetë, ajo nisi më 19 korrik 1737 kur feldmareshali austriak Sekendor nga Tershice afër Nishit nxori një thirrje popullatës së krishterë (katolike dhe ortodokse), që t'i bashkohet luftës

---

edhe për masat e ashpra represive që turqit kanë marrë ndaj popullatës shqiptare pas largimit të Austriakëve. Kazazi flet për katunde të tëra të rrënuar a dhe për vrasjen e famullitarëve katolikë. (Faqe 80).

<sup>893</sup> Sipas burimeve austriake numri i Shqiptarëve të shpërngulur nga pjesët që theksohen në Shqipëri arrin deri në njëzet mijë. Këtë e vërtetojnë edhe burimet e Vatikanit dhe ato të Venedikut. Shih H. Gera: “*Die Kaiserlichen in Albanien 1689*”, Vjenë 1888; C. Contanrini: “*Storia della guerra di Leopoldi primo imperadore e de principi collogati contra il Turco dall 1683-fino alla pare*”, Vendik 1710.

<sup>894</sup> Milorad Bošnjak-Slobodan Jakovljević: “*Karadževići – skrivena istorija*”, Gornji Milanovac, 2007.

<sup>895</sup> Historiografia serbe ka bërë përpjekje të vazhdueshme që të manipulojë si me luftën austro-osmane si me shpërnguljen e popullatës së atjeshme, duke u munduar që pjesëmarrjen e Shqiptarëve në atë luftë ta minimizojë duke e paraqitur atë vetëm si pjesë të parëndësishme të saj, ndërkohë që roli i krishterëve ortodoksë, të parë kryesisht serbë, do të stërmadhohet, sidomos shpërngulja, e cila do të paraqitet e përmasave rrënuese, ngaqë nga Kosova, nga frika e hakmarrjes turke, do të largohet thuajse pjesa më e madhe e saj dhe vendin e saj do ta zënë Shqiptarët që do të zbrisin nga krahinat malore të Shqipërisë dhe do ta popullzojnë atë! Ndër autorët serbë që do të ushqejnë këtë tezë dallohen: J. Cvijić: “*Osnove za geografiju i geologiju Makedonije i Stare Srbije*”, 1906; Djordjeviq Vladan: “*Die Albanens und die Grossmächte*”, Leipzig, 1913; B. Nushić: “*Kosovo – opis zemle i naroda*”, Novi Sad 1962; D. Popović: “*Velika seoba srba*”, Beograd 1954; “*Istoria naroda Jugoslavije*”, knjiga 2, Beograd 1960.

<sup>896</sup> Shih Rizaj, S.: “*Kosova dhe Shqiptarët dje, sot dhe nesër*”, Prishtinë 1992.

kundër osmanëve. Bëhet e ditur se, si me rastin e luftës së parë të drejtuar nga Pikolomeni para dyzet vitesh, edhe këtë herë, thirrjes së feldmarshallit austriak iu përgjigjen një pjesë e mirë e shqiptarëve të krishterë (katolikë dhe ortodoks) nga fiset e veriut, kryesisht Kelmendasit, po ku kishte edhe nga fiset e Hotit, Piperit, Vasojeviqëve dhe të Grudës. Atyre do t'u prijë patriarku ortodoks Shakabenta, një pjesë e të cilëve, kishin qenë të përfshirë edhe në luftërat midis Turqisë dhe Venedikut të viteve 1715-1718 prej nga pastaj do të vazhdojë odiseada e tyre nga Malësia e Madhe për në pjesët e Peshterit dhe Rugovë.<sup>897</sup>

Meqë fatet e luftës, edhe këtë herë, nuk ishin në anën e austriakëve, të cilët, pas dy vitesh do ta humbin atë, ndërsa feldmareshali austriak Sekdender, në tërheqje e sipër, la në mëshirën e pamëshirë jo vetëm luftëtarët shqiptarë (katolikë dhe të krishterë) dhe të tjerë, ishte e prithshme që rikthimi i ushtrisë osmane në pjesët që për dy vjet kishte mbajtur ushtria austriake, të përcillet me terror ndaj atyre që kishin marrë anën e austriakëve. Për Kelmendasit dhe pjesëtarët e fiseve veriore kjo do të thoshte një eksod tjetër. Bëhet e ditur se rrugën e pasigurtë drejt veriut pas ushtrisë austriake e morën rreth dhjetë mijë shqiptarë të krishterë, të shumtën Klemendas, nën mbikëqyrjen e patriarkut ortodoks Shakobeta dhe arqipeshkvit katolik M. Suma. Ata kaluan në Srem si refugjatë dhe pas shumë peripecishë u vendosen në katundet Hrtkovci, Nikinci dhe Mishkoc, ku edhe mbetën përgjithmonë. Vlerësohet se në pjesën e Austro-hungarisë, arritën 1600 shqiptarë nga 10 mijë sa morën arratinë, nga trojet e tyre (Peshteri dhe Rugova). Pjesa më e madhe e tyre mbeti rrugës, qoftë e masakruar nga hakmarrja e ushtrisë osmane, ose nga sëmundjet dhe uria që i përcolli gjatë eksodit gjashtë javësh, deri sa kaluan lumin Sava.<sup>898</sup>

## RITI ORTODOKS DHE GJUHA SHQIPE

Përpyekjet shumëshekullore të Shqiptarëve, që në përpëlitjet e tyre midis Perëndimit dhe Lindjes përherë të angazhohen që pasojat e vijës së ndarjes së

<sup>897</sup> Më gjerësisht rreth pjesëmarrjes së Kelmendasve dhe pjestarëve të disa fiseve të tjera në luftën austro-turke të vitit 1737-1739 shih: Radonić, Jovan: “*Rimska kurija i južnoslovenske zemlje od XVI do XIX veka*“, Beograd, 1950; Kostić, Mita: „*Ustanak Srba i Arbanasa u Staroj Srbiji protiv Turske 1739*“ I, Shkup 1929; Zefiq, Frok: „*Shqiptarët Kelmendas në Hrtkovci e Nikinci 1737-1739*“, Zagreb, 1979.

<sup>898</sup> Shih: Kuhać, Š, Franjo: “*Die Klimentiner in Slavonien*“, Zagreb, 1894; Ivanišević, Mate: “*Hrvatski Albanci ili Klementinci*“, Zagreb, 1914; Kostić, Mita: “*Arnauti u Sremu*“, Beograd, 1923; Popović, K, Sava: “*Arnauti u Sremu*“, 1939; Šimrak, Janko: “*Albanci iz Nikinaca u Zavodu*“, Zagreb, 1931 dhe “Zefiq, Frok: “*Shqiptarët Kelmendas në Hrtkovci dhe Nikinci (1737-1997)*“, Zagreb, 1997.

qytetërimeve të shfaqur që nga koha e perandorit Teodosi, në shekulli e katërt të mos kthehen në një luftë të brendshme dhe veçmas që të shkëputen nga hapësira perëndimore si interes i shumanshëm i tyre, do të ishin të mangëta pa pasqyrimin e luftës së përhershme që do të zhvillohet edhe brenda për brenda ritit ortodoks, që ai të ruajë frymën e lidhjes me Perëndimin, siç do të ndodhë gjatë kohës së Jusit-nianit e deri te pushtimet bullgare, kur përkatësia administrative (lindore) do të baraspeshohet me përkatësinë kishtarë perëndimore, në vend të konfrontimit më të, që shfaqej në raportet midis Romës dhe Kostandinopojës pas ndarjes së tyre nga viti 1054 e këndej, pale se në këtë rrugë do ta ketë shumë të vështirë nga shkaku se përballë kishte dogmën bizantine në njërin anë dhe mungesën e autoqefalisë në tjetrën anë, që pengonte që në kuadër të ritit ortodoks përkatësia kishtarë të identifikohet edhe me interesat identitare, siç do të ndodhë me sllavët, bullgarët, grekët, rumunët dhe të tjerët në Ilirik në rrethanat e pushtimeve osmane dhe zhvillimet e mëtejme që do të çojnë te krijimi i shteteve nacionale.

Edhe gjatë kohës së Despotatit të Epirit dhe të *“Mbretërisë së Arbërisë”*, nën dinastinë anzhvine, kur praktikisht do të shfaqen strukturat e para të shtetësisë arbërore në rrethanat e shpërbërjes së Bizantit, bujaria, dhe më vonë edhe princat e Arbrit, do të bëjnë përpjekje që ndarjet kishtarë të mos ndikojnë gjithaq në përcaktimet e tyre që lufta për frone, pa marrë parasysh se të çfarë natyre ishin dhe me çfarë niveli vasalitetesh lidheshin, të kalonte nëpër përkatësinë ekskluzive, veçmas nëse lidhej me atë lindore, siç kishte ndodhur në fazën e fundit të shpërbërjes së Bizantit, kur rikthimi i tij paraqiste njëherësh luftë kundër Perëndimit. Ndërsa, po atëherë, nga kjo pjesë e botës, do të hetohen shenjat e para të afrive me Osmanët, që së shpejti do të kthehen në forma vasalitetesh të hapura ndaj tyre. Vendoçja e plotë e pushtetit osman nga gjysma e dytë e shekullit XV, kur edhe do të bjerë Kostandinopoja në duar të Osmanëve dhe me këtë edhe formalisht do të marrë fund ngrehina e fundit e Bizantit, ndarjen kishtarë Lindje-Perëndim do ta ashpërsojë skajshmërisht. Në vend se të ishte e kundërta, pra që bashkërisht të përqendroheshin kundër të njëjtit armik, Patrikana e Kostandinopojës, gjithnjë nën moton e njohur adaptuese ndaj rrethanave shoqërore dhe politike qofshin ato edhe nën pushtues se *“ku është besimtari është edhe kisha”*, do të pranohet pushtetin e sulltanit, me çka do të vihet nën mbikëqyrjen e Portës së Lartë, e cila si kundërshpërblim të krishterëve ortodoksë do t’u garantojë mbrojtje dhe lirinë e besimit. Në këtë aspekt, pranimi i autoqefalisë nga sulltani, kishën ortodokse e kthente në një bashkëpunëtoare të ngushtë, ngaqë ajo, për të ruajtur pushtetin shpirtëror, fitonte të drejtën e mbledhjes së tatimeve nga besimtarët e vet, për ç’gjë shpërblehej me

një përqindje të mirë nga sulltani, për shërbimet e bëra. Kësaj do t'i ndihmojë edhe strategjia e pranimit të vasaliteteve nga princat sllavë dhe grekë. Ata, ndër të parët do t'i nënshtrohen sulltanit dhe do t'i vihen në shërbim të hapur kundër vendeve katolike dhe popujve me besim katolikë në luftën e tyre mbrojtëse kundër depërtimeve osmane, ku despotët e fundit Rasiënë do të dallohen së tepërmi me pjesëmarrjen e tyre kundër Huniadit dhe në fushatat e tjera osmane drejt Perëndimit. Siç dihet, trupat rasiene, do të gjenden në pararoje edhe të sulmeve gjatë marrjes së Kostandinopojës, duke luftuar me përkushtim për rrënimin e saj, por edhe në shumë e shumë beteja të tjera në hapësirat europiane.<sup>899</sup>

Koha e vasaliteteve dhe ajo e pranimit të pushtetit të Portës së Lartë, arbitrit e besimit ortodoks do t'i ballafaqojë me sllavizim ose greqizim (helenizim), meqë që të dyja gëzonin autoqefalinë dhe të drejtën e ushtrimit të liturgjisë në këto gjuhë. Kështu, arbitrit e ritit ortodoks, në mungesë të liturgjisë në gjuhën e tyre, do të ballafaqohen edhe me ndalimin e ashpër të çfarëdo veprimi në këtë drejtim, pa marrë parasysh se mund të ishte në dobi të mbajtjes së besimtarëve në radhët e veta. Kjo do të pasqyrohet në hapësirën e Maqedonisë antike, të Dardanisë dhe të Epirit, ku riti lindor thuajse kishte shtrirje të përgjithshme, por ku gjuha e liturgjisë (greqishtja ose sllavishtja e vjetër kishtare), ndikonte te përcaktimi i identitetit etnik helen apo sllav, që në rrethanat e mëvonshme do të konvertohet në vetëdije kombëtare. Dhe kjo do të jetë njëra ndër arsytet pse një pjesë e mirë e popullatës shqiptare në rrethanat kur mbetja në kuadër të ortodoksisë statusi shoqëror i rajës e degradonte dyfish, për t'i ikte pozitës të nënshtimit të dyfishtë, pa ndonjë hezitim, jashtë hapësirave të vetëqeverisjes me anën e kanunit, në pjesët gjysmë-urbane dhe urbane, pranoi islamin, siç do ta pranojnë edhe bogumilët në Bosnje, të cilët po ashtu ishin shumë të rrezikuar nga hegjemonizmi kishtar ortodoks. Kjo do të ndodhë në pjesët e skajshme, jashtë ndikimit të peshkopatave, të cilat, qoftë edhe si ortodokse, merreshin si pjesë e autoktonisë shqiptare, siç do të jetë ajo e Ohrit dhe më vonë edhe e Durrësit nën juridiksionin e të cilave do të bien një pjesë e madhe e dioqezave të Shqipërisë.

Nga fillimet e shekullit XVII, pas riorganizimit kishtar që do të kushtëzohet nga mvetësimi i kishës ruse, Patrikana e Stambollit, e cila edhe më tutje, në saje të besimit që gëzonte nga Porta e Lartë, do ta konsiderojë veten udhëheqëse shpirtë-

<sup>899</sup> Më gjerësisht rreth përfshirjes së Serbëve në anën e Osmanëve shih Jireček, Konstandin: “*Historia e serbëve*”, Tiranë; Jorga, J.: “*Geschichte des osannischen Reichs*”, Gotha, 1909; Hammer, J. V “*Istorija osmanskog carstva*”, I,II, Zagreb, 1986; Chacondil, L. N: “*L’Histoire de la degandence l’Empire et Etablissement de celyy des Turcs*”, Paris 1962; “*Historia e Popullit Shqiptar*”, I, Tiranë 2002; Murzaku, Th: “*Historia e Ballkanit*”, Tiranë 1973; Plasari, Aurel: “*Skënderbeu*”, Tiranë 2010;

rore të ortodoksisë, me “mandatin perandorak”, do t’i kthehet greqizimit të plotë. Kjo do të zgjojë pakënaqësi te kisha Rasiene e lidhur me atë sllave, ajo rumune dhe bullgare. Këto të fundit, për t’u liruar sadopak nga fryma e trysnisë së helenizimit që ushtronte kisha greke, me ndihmën e patrikanës së Stambollit, filluan vënien e lidhjeve të veçanta me Romën. Kisha Rasiene tregoi prirje për t’u lidhur me atë të Rusisë. Patrikana e Ohrit, e cila kishte nën mbikëqyrje edhe dioqezat në hapësirën arbërore, e cila nga administrata osmane fillimisht ishte përcaktuar si sanxhak i Shqipërisë dhe më vonë do të degëzohet në sanxhakun e Ohrit dhe do të përfshinte hapësirën nga Ohri, Dibra dhe mes për mes Shqipërisë do të shkonte deri në Krujë dhe Lezhë,<sup>900</sup> kishte shumë arsye që t’i kundërvihet greqizimit të patrikanës së Stambollit. Jo vetëm pse mohonte ekzistencën e identitetit bullgar dhe të atij shqiptar, por edhe pse ajo, për ta ruajtur pushtetin e vet, kërkonte t’i largohej sa më shumë që të ishte e mundur frymës perëndimore, e cila në Europë, me shfaqjen e Humanizmit dhe të Renesancës, kishte filluar të tregonte shenjat e lulëzimit, të cilat po përcilleshin me interesim edhe në brigjet lindore të Adriatikut.

Në të tilla rrethana, kur idetë iluministe europiane preknin edhe vendet perëndimore të Ilirikut, në Voskopojë, në një qytet zejtar, kryesisht të banuar me popullatë shqiptare të besimit ortodoks e ku kishte edhe një minoritet të rëndësishëm vllah, prania e të cilit kulturarisht hetohej në shumë pjesë gjithnjë duke u ndërlidhur me identitetin etnik të popullatës shumicë,<sup>901</sup> jo rastësisht, do të shfaqet një qark kulturor, i cili do të manifestojë frymën e civilizimit perëndimor. Kështu që në këtë qytet, qysh në vitin 1710, u ngrit një kolegji në gjuhën greke, por jashtë ndikimit helen dhe, dhjetë vjet më vonë, qyteti u pajis edhe me shtypshkronjë, e cila u krijoi intelektualëve voskopojarë bazën materiale për një zhvillim të shpejt kulturor. Më 1744, me përkrahjen e Joasafit, një grup intelektualësh themeluan “*Akademinë e re*”, programi arsimor i së cilës ishte ai i shkollave të mesme të Europës.<sup>902</sup>

Rektor i parë i Akademisë qe Sevast Leontiadhi nga Kosturi, i lauruar në Universitetin e Padovës. Pas tij rektor do të bëhet Theodor Kavalioti nga Voskopoja,

<sup>900</sup> Më gjerësisht rreth organizimit kishtar në hapësirën shqiptare në rrethanat e pushtimit osman shih Gjini, Gaspër: “*Skopsko-prizrenska biskupija kroz stoljeća*”, Zagreb 1986; Radonjić, J: „*Rimska kurija i jugoslovenske zemlje od XVI-XIX veka*“, Beograd 1950; Mirdita, Zef: „*Krishtërizimi ndër shqiptarë*”, Prizren-Zagreb 1998.

<sup>901</sup> Më gjerësisht rreth pranisë vllache në ambientin shqiptar nga mesjeta deri te koha më e re shih Mirdita, Zef: “*Vlasi u albanskoj historiografiji*”, Zagreb 2004, faqe 59-73; Bartl, Peter: “*Quellen und materialien zur albanischen Geschichte in 17 und 18 Jahrhundert*”, Mynchen 1979; Rizaj, Skënder: “*Uloga Vlaha princiçura u rudarstvu Kosova i Srbije u XV i XVI veku*”, në Simpozijum II/1983, faqe 135-138; Frashëri, Kristo: „*Etnogjeneza e Shqiptarëve*“, Tiranë 2013.

<sup>902</sup> “*Historia e popullit shqiptar*”, vëllimi i parë, Prishtinë, 1969, faqe 387.



mendimtar i shquar i shekullit XVIII, ithtar i zjarrtë i pikëpamjeve filozofike të Lajbnicit, që njëherësh do të jetë edhe përkthyesi i parë i “*Dhiatës së re*” në gjuhën shqipe. Në vitin 1770 botoi edhe një fjalor të gjuhës greqisht-arumunisht-shqip dhe me këtë, dyqind e sa vjet pas shfaqjes së “*Mesharit*” të Buzukut në gjuhën shqipe i vuri bazat kombëtare edhe kishës ortodokse shqiptare, e cila do të presë plot dy shekuj të tjerë për ta shpallur autoqefalinë dhe në këtë mënyrë edhe ajo të deponojë në identitetin e përgjithshëm kulturor shqiptar, gjë që do të paraqesë një fitore tjetër historike në luftë me hegjemonizmin grek dhe megaloidenë e njohur “se çdo grek është ortodoks dhe çdo ortodoks është grek”.

Ngritja e Voskopojës në një qendër kulturore me frymë perëndimore, ku edhe Shqiptarët e ritit ortodoks, me përkthimin e veprave kishtarë në gjuhën shqipe, fillojnë të lirohen nga prangat e kishës greke, njëherësh do të paraqesë fillimin e përpjekjeve të bashkuara midis Patrikanës greke të Stambollit bashkë me Portën e Lartë, për rrënimin e saj. Dhe kjo prapaskenë e ndërlidhur do të fillojë me suprimimin e patrikanës së Ohrit nga ana e patrikanës së Stambollit, që paraqiste një hap tjetër të rëndësishëm drejt eliminimit të një qendre e cila shikonte nga ana tjetër e botës. Më 1779, gjatë luftës ruse-osmane, kur kleri ortodoks dhe paria e Voskopojës përkrahën himarjetët, të cilët po atë vit ngritën krye kundër sundimtarëve osmanë, ka të ngjarë që kjo, si intrigë e kurdisur apo e ngjashme, mund të ishte ndërlidhur njëherësh edhe me përkrahjen e luftës ruse-turke, në mënyrë që voskopojarëve t’u merrej si shkas për sulm ndaj tyre. Porta e Lartë gjeti rastin për të nxitur kundër Voskopojës *derebejt* (ruajtësit e qytetit), të cilët gjoja të pakënaqur nga vonesat e pagesës së shumës së kontraktuar me voskopojarët për mbrojtjen e qytetit, e sulmuan këtë, e plaçkitën dhe e dogjën.<sup>903</sup>

Një rrënim të ngjashëm qyteti pësoi edhe më 1772 dhe 1789. Veç kësaj edhe Patrikana e Stambollit mori masa të ashpra kundër Voskopojës në lëmin e kulturës. Pedagogët e mëparshëm u dëbuan dhe u zëvendësuan me pedagogë të lidhur pas Patrikanës, me qëllim që fryma e Akademisë t’u shërbente interesave helenizuese. Kështu, në njërin nga tekstet e hartuara prej mjeshtër Dhanielit, përfaqësuesit të rrymës shoviniste greke-ortodokse, autori i ftonte nxënësit shqiptarë, vllahë dhe bullgarë të hiqnin dorë nga “gjuhë e tyre barbare” dhe të mësonin vetëm greqisht. Në këto rrethana Akademia nuk e vazhdoi më veprimtarinë e vet.<sup>904</sup>

Shkatërrimi dhe rrënimi i Voskopojës dhe mbyllja e “*Akademisë së re*”, edhe pse nga disa burime është quajtur “*si hakmarrje e paramenduar e shqiptarëve*

<sup>903</sup> Po aty, faqe 390.

<sup>904</sup> Po aty, faqe 390.

*myslimanë nga ndikimi i Athinës ortodokse*”, që në hapësirën e saj të mos lejohet “pyka greke” dhe të ngjashme, megjithatë flet për të kundërtën. Pra, për frikën e Patrikanës së Stambollit dhe vetë Portës së Lartë nga përhapja dhe ndikimi i frymës iluministe perëndimore te faktori ortodoks, që shfaqej jashtë ndikimit të kishës greke dhe hegjemonizmit të saj, veçmas ndaj një kishe peshkopate ortodokse, siç ishte ajo e Ohrit, e cila përkrahte lëvizjet çlirimtare të popujve të Ballkanit, në radhë të parë të Bullgarëve dhe të Shqiptarëve si dhe identitetin e tyre nacional, i cili duhej të pasqyrohej me lejimin e përdorimit të gjuhës kombëtare në mesha dhe liturgji fetare.

Vazhdimi i përpjekjeve për shqipërimin e librave kishtarë nga nxënës ose bashkëpunëtorë të Kavaliotit edhe pasi që të rrënohet Voskopoja dhe të mbyllet “*Akademia e re*”, do ta vërtetojnë këtë. Kështu, në luftën kundër reaksionit grek-ortodoks të Patrikanës së Stambollit që e ndalonte përkthimin e librave kishtarë në gjuhët kombëtare të popullsisë me besim ortodoks, disa klerikë Shqiptarë jo vetëm i përkthyen shqip, por librat e përkthyer i botuan në një alfabet të veçantë, të sajuar posaçërisht për gjuhën shqipe që nuk i përngjiste alfabetit grek.

Njëri nga këta ishte peshkopi i Durrësit, Grigor Durrsaku. Ky përktheu shqip “*Dhiatën e re*” (1761). Gjurmët e Grigor Durrsakut i ndoqi Dhaskal Todhëri (Theodor Haxhi Filipi), i cili do të përkthejë shqip “*Dhiatën e re*” dhe pjesë të liturgjisë. Veç kësaj, Dhaskal Todhëri u përpoq të themelonte një shtypshkronjë në Elbasan për të botuar vepra shqip. Por kur, më 1805, po kthehej nga Venediku, së bashku me materialet e shtypshkronjës, rrugës për në Elbasan, u vra nga njerëz të panjohur, pa mundur kështu të hapte shtypshkronjën shqiptare.<sup>905</sup>

Vrasja e Dhaskal Todhërit, e ngjashme me atë të mbytjes tragjike të PjetërBudut në lumin Drin, pse kishte kërkuar prelatët që dinin gjuhën shqipe dhe në të do ta bënin meshën, nuk do ta ndalë as angazhimin e klerit katolik shqiptar dhe, më vonë të atij ortodoks shqiptar, drejt emancipimit të Shqiptarëve dhe zgjimit të tyre kombëtar në frymën e qytetërimit perëndimor, frymë kjo që në shekujt e mëvonshëm në tërësi do të pranohet nga rilindësit kombëtarë dhe do të futet në programet e tyre për çlirim kombëtar dhe shtet të pavarur.

---

<sup>905</sup> Po aty, faqe 391.

## KAPITULLI I KATËRT

### REFORMAT E TANZIMATI DHE PËRPJEKJET PËR MODERNIZIM

#### TANZIMATI DHE LËVIZJET PËR PAVARËSI

Fillimet e shekullit të nëntëmbëdhjetë Perandorinë Osmane e gjetën në vorbullën e përpëlitjeve vendimtare për ta siguruar ardhmërinë jo më duke u mbrojtur nga shkëputjet dhe rrudhjet që i vinin në luftërat e vazhdueshme që bënte në lindje me Rusinë dhe të shumtën i humbte me pasoja, por me anën e ndryshimeve të brendshme, të cilat do të bënin që mekanizmat e saj të vjetruara dhe të shumtën të ndryshkura, të zëvendësoheshin me ato që tashmë kishin zënë të përdorëshin në Perëndim. Despotizmi feudal dhe obskurantizmi fetar duhej të zëvendësoheshin me monarkinë kushtetuese. Ky tashmë ishte një qëndrim i përbashkët i Sulltanatit dhe i atyre fuqive europiane, të cilat ishin të interesuara që Perandoria Osmane me anën e reformave të brendshme gjithëpërfshirëse të kthente fuqinë që kishte në përputhje me ndryshimet e kohës.

Para se të arrihej deri te çastet që Perandoria Osmane, së paku formalisht, të niste reformat drejt modernizmit të saj, që do të bëhen me shpalljen e “*Hat-i Sherifit*”<sup>906</sup> dhe do të marrin një formë institucionale me “*Hat-i Hymajanin*”<sup>907</sup>, sprovën e kësaj sfide ajo duhej ta kalonte me dy ballafaqime të brendshme tejet të vështira. I pari kishte të bënte me rrënimin e fuqisë së jeniçerëve dhe të pushtetit të

<sup>906</sup> “*Hat-i Sherifi*” u hartua nga veziri i madh, Mustafa Rashit Pasha, i cili ishte njëri ndër reformatorët kryesor të kohës. Më 3 nëntor 1839 ai u shpall solemnisht nga Sulltan Mexhidi në pallatin e quajtur *Gjylhane* (salla e trëndafilave) dhe sipas asaj ceremonie mori edhe emrin “*Hat-i Sherif i Gjylhanës*”, ose “*Dekreti i shenjtë i Gjylhanës*”. Sipas këtij dekreti hiqet rendi i spahinjve në dobi të çifllëkut, formë e pronës private, të cilën mund ta posedojë secili qytetar i Perandorisë pa dallim feje e race. Me këtë ligj edhe të krishterët fitojnë të drejtën e pronës. Në dekret pos tjerash thuhet: “Nga tash do t’u ofrohet siguri e plotë të gjithë nënshtruesve (qytetarëve) të mi myslimanëve dhe rajës (të krishterëve), nderit dhe pronës së tyre... Prej tash, nga më i madhi deri te më i vogli në shtet, nga veziri im e deri te bariu i thjeshhtë, secili do të posedojë pronën sipas dëshirës, nga e cila askush nuk mund ta privojë”.

<sup>907</sup> “*Hat-i Hymajani*”, shpall në Stamboll në vitin 1856 dhe shënon hapin më të rëndësishëm të Perandorisë Osmane drejt kalimit tek monarkia kushtetuese. Ky dokument shpallte barazinë fetare, me çka formalisht fesë islame i merrej primati që kishte, por njëherësh që të krishterët dhe hebrenjtë i privonte nga e drejta e vetadministrimit, të cilën e kishin shfrytëzuar deri më atëherë dhe u kishte ndihmuar që liritë fetare dhe gjuhësore të përcaktojnë edhe shkallën kulturore gjatë qeverisjes lokale.

tyre tepër të madh, i cili prej kohësh kishte filluar t'i kthehet në pengesë serioze pushtetit qendror. Dhe i dyti - lidhej me qërimin e hesapeve me pashallarët e padëgjueshëm, fillimisht me Mahmut Pashë Bushatliun e Shkodrës dhe Osman Pazvanogllun në Vidin, e pastaj edhe me Ali Pashën e Janinës, të cilët, si despotë vendorë, me përpjekjet e tyre për t'u pavarësuar nga Porta, bëheshin edhe më të rrezikshëm, ngaqë joshnin edhe më tutje lëvizjet separatiste në Ilirik, të cilat Rusia, por edhe fuqitë tjera, që edhe përkundër zotimeve që merrnin për ta mbrojtur pushtetin qendror të Portës, siç ishin ato që do të formulohen në marrëveshjen e paqes së Parisit, të vitit 1856, kur Perandoria Osmane do të pranohet në korifeun e fuqive të mëdha të Europës dhe do t'i garantohet tërësia territoriale, përpriqeshin me të madhe t'i shfrytëzonin për të zgjeruar ndikimin e tyre në këtë pjesë.<sup>908</sup>

Të dyja këto veprime, krahas pasojave që do të kenë për zhvillimet e mëtejshme në pjesën europiane të Perandorisë Osmane drejt nxitjes së nacionalizmave dhe lëvizjeve për shkëputje të popujve të krishterë (Serbëve, Grekëve, Malaziasve, Rumunëve dhe Bullgarëve), njëherësh do të ndikojnë edhe në raportet e Perandorisë Osmane me Shqiptarët nga bashkëpunimi, afria te disa çështje, që shiheshin me interes të përbashkët, e deri tek mospajtimet dhe kundërshtimet madje të përcjella me kryengritje. Çështja pse këto ndryshime shiheshin me mosbesim dhe kundërshtim madje, kishte të bënte me atë se shkatërrimi i rendit të jeniçerëve, në njërën anë do të thoshte privim nga një institucion i rëndësishëm ushtarak, ku gjatë tre shekujve ishin ndër pjesëmarrësit kryesor në atë fuqi dhe në shumë raste e edhe e drejtonin, ndërkohë që në tjetrën anë, rrënimi i pashallëqeve, fillimisht i atij të Shkodrës e më vënë edhe të Janinës, po ashtu i privonte nga pushteti i rëndësishëm vendor që kishin gëzuar feudalet shqiptarë, të cilët prej kohësh kishin ndërtuar një qeverisje thujtë të pavarur ekonomike dhe administrative, e cila jo vetëm që duhej të kalonte në duart e pushtetit qendror, por shkapërderdhja e fuqisë së tyre duhej të bëhej edhe duke ia shpërndarë popullatës së krishterë, e cila ishte pakicë në hapësirën etnike të tyre, por në rrethanat e reja, ajo fitonte fuqi të madhe, veçmas kur Perandoria do të pranojë që përkujdesja shpirtërore dhe kulturore për popullatën sllavo-ortodokse të kalojë tek Rusia dhe për atë katolike te Vjena.<sup>909</sup>

Ishte, pra fjala, për dy çështje që preknin në thelb në njërën anë raportet e Shqiptarëve me Perandorinë Osmane, dhe raportet e brendshme shqiptare në tjetrën anë. Këto të fundit, ishin tepër të ndjeshme, për faktin që ata ishin të ndarë në

---

<sup>908</sup> Shih Castellan, Georges: "Historia e Ballkanit", Tiranë 1991, faqe 241-255; Glen, Misha. "Historia e Ballkanit 1804-1999", Tiranë.

<sup>909</sup> Shih Skendo, Stavro: "Zgjimi kombëtar shqiptar", Tiranë 2000;

tri fe (shumica në atë islame dhe pakica në të krishterë që u takonin dy riteve, atij të kishës lindore nën Kostandinopojën dhe perëndimore nën Vatikanin), gjë që shkapërderdhja e mëtutjeshme e mbikëqyrjes së tyre fetare (në rastin konkret e ortodoksëve nga Rusia dhe e katolikëve nga Austria), praktikisht do të thoshte përçarje e brendshme dhe rrezikimi drejtpërdrejtë i etnisë së tyre nga fqinjët, të cilët të krishterët shqiptarë kishin filluar t'i përvetësonin për qëllimet e tyre nacionaliste, duke i helenizuar ose sllavizuar me të madhe.

Ky zhvillim, thuajse detyrimisht do të ndikojë edhe tek proceset e lindjes dhe të forcimit të shqiptarizmit<sup>910</sup>, si nevojë e shprehjes së identitetit kombëtar, për deponimet që u duheshin projekteve shoqërore dhe politike kundruall sfidave të kohës me të cilat ballafaqohej Perandoria, por edhe si kundërpërgjigje “*megali idesë*”<sup>911</sup> greke dhe projekteve hegjemoniste serbomëdha që do të shfaqen pas “*Naçertanjes*”<sup>912</sup> së Garashaninit me të cilat drejtpërdrejt rrezikohej etnia shqiptare dhe ekzistenca e saj.

Roli mbrojtës dhe ai i kundërpërgjigjes, Shqiptarët jo rrallë do t'i sjellë para situatave absurde, sepse mbrojtja e interesave të tyre, shikuar nga pikëpamja e ruajtjes së interesave vitale, nënkuptonte kundërshtimin e frymës së reformave – siç ishte rezistenca që i bëhej centralizmit që rrëronte qeverisjen tradicionale vendore, ndërkohë që të shumtën binte ndesh me to, veçmas kur prej tyre kërkohesh trajtim i barabartë me të tjerët.

Pa mëdyshje se fillimisht sfida e jeniçerëve tashmë të pushtetshëm jashtë mbikëqyrjes dhe ajo e pashallëqeve të padëgjueshme, që në njëfarë mënyre ishin të ndërlidhura dhe plotësonin atë që shfaqej si rebelim ndaj pushtetit qendror mbi bazat e despotizmit feudal imun nga çfarëdo ndryshimi pozitiv shoqëror dhe politik, kërkonte një veprim përkushtues nga lartë dhe nga dorë e fortë. Kjo, madje, jo vetëm pse kthimi i autoritetit qendror e forconte atë nga brenda, por kishte të bënte edhe me pengimin e faktorit të jashtëm i interesuar që pashallëqet t'i shfrytë-

---

<sup>910</sup> Rreth *shqiptarizmit* si moto të zgjimit kombëtar shqiptar dhe kthimit në program të Rilindjes Kombëtare shih: Skendo, Stavro: “*Zgjimi kombëtar shqiptar*”, Tiranë 2000; Clayer, Nathalie “*Në filltet e nacionalizmit shqiptar*”, Tiranë 2009.

<sup>911</sup> “*Megali ideja*” ose “*Ideja e madhe*” do të shfaqet në nëntor të vitit 1844 nga kryeministri grek N. Koletis, ku kërkohesh rikrijimi i një perandorie bizantine në, bartëse e të cilës do të ishte Greqia. Ky projekt përfshinte thuajse që të gjitha pjesët e Greqisë dhe të Ballkanit qendror në përputhje me shtrirjen e ortodoksisë. Në të vërtetë ky projekt hegjemonist grekomadh synonte okupimin e një pjese të madhe të Shqipërisë (deri te lumi Shkumbin), Maqedoninë si dhe një pjesë të Bullgarisë.

<sup>912</sup> “*Naçertanja*” u shpall nga ministri i jashtëm serb Ilia Garashanin dhe mbështetej mbi të ashtuquajturën të drejtë historike serbe mbi pjesën më të madhe të Ballkanit në përputhje me mbretërinë mesjetare të Dushanit. Sipas Garashaninit, Serbia duhej të merrte rolin e piemontit sllav në Ballkan dhe ata t'i bashkonte në një shtet të madh, i cili do të kishte dalje në dy dete (Egje, Adriatik).

zojë për dobësimin e saj nga brenda, që me anën e tyre të fillojë procesin e shpërbërjes së mbikëqyrur të saj në pjesë të ndryshme.

Natyrisht se sfida e reformave gjithëpërfshirëse, veçmas atyre ekonomike dhe shoqërore, si një përgjigje ndaj problemeve të mëdha nga brenda tashmë të grumbulluara, që kërkonin zgjidhje të shpejtë dhe gjithëpërfshirëse, do të gjejë përkrahësin e vërtetë me shfaqjen e Sulltan Selimit III, i cili gjatë pjesës më të madhe të moshës së rinisë kishte qenë i mbyllur në kafazin e artë të pallatit perandorak, ku i qenë lejuar takime me disa njerëz të rangjeve të larta, po edhe të huaj, të cilët e kishin bindur për domosdoshmërinë e reformave me anën e të cilave Perandoria do të fitonte mundësitë për t'u ringjallur në përputhje me frymën e kohës.<sup>913</sup>

Kur Selimi III doli nga mbyllja, ai nuk kishte kurrfarë përvojë për punët e kësaj bote, por tashme ishte luftëtar i zjarrtë për ndryshime. Ishte i vendosur që të rivendoste autoritetin e shtetit brenda vendit dhe ta bënte të rimerrte veten si fuqi e madhe përkrah të tjerave të kohës me të cilat duhej të matej pareshtur. Meqë, gjatë katër vjetëve të para të sundimit të tij Perandoria Osmane që në luftë me Habsburgët dhe nuk ishte koha të niste reformat, priti deri në vitin 1794, kur shpalli planet e tij për “*Nizam-i Xhedit-in*” (Rendi i ri ushtarak).

Esenca e këtij plani kishte të bënte me krijimin e një ushtrie moderne, e të stërvitur kryesisht nga oficerët francezë sipas arritjeve të shkencës ushtarake dhe do të ishte në përputhje me sfidat e kohës me të cilat gjithnjë e më shpesh ballafaqohej Perandoria. Për ta realizuar këtë projekt të rëndësishëm nga i cili varej e ardhmja e Perandorisë, sulltani kërkoi nga veziri i madh që funksionarët e lartë civilë të dërgonin raporte (*layiha*) mbi reformat që mendohej se duheshin bërë. Shtatëmbëdhjetë prej këtyre dokumenteve njihen, ato trajtojnë kryesisht problemet lidhur me jeniçerët dhe me *spahitë* me të gjitha pasojat financiare që lidheshin me organizimin e tyre. Një varg dekretesh (*khatt-i sherif*) u nxorën për t'i jetësuar këto ide, ku *Nizam-i xhedit*, që u quajt edhe korpus special i trupave, kishte një rëndësi të veçantë.<sup>914</sup>

Edhe pse sfida ushtarake ishte testi i parë i mbijetimit të Perandorisë, megjithatë përballja me jeniçerët dhe oficerët e lartë të ushtrisë në krye jo vetëm që nuk ishte punë e lehtë, por ajo shfaqej me rreziqe të mëdha dhe të paparashikueshme fare, ngaqë me këtë rend ushtarak, i cili kishte merita të mëdha në të kaluarën për forcimin e Perandorisë, ishin të lidhura jo vetëm klasat e privileguara të Perandorisë, të cilat kërkonin ndaljen e kohës bashkë me zhvillimin e saj, por me të ishin

<sup>913</sup> Glenny, Misha: “*Historia e Ballkanit 1804-1999*”, Tiranë, 2007, faqe 3.

<sup>914</sup> Shih Castellan, Georges: “*Histori e Ballkanit*”, Tiranë, faqe 246.

të lidhura edhe mentalitetet e caktuara shoqërore, që i takonin kohezionit të brendshëm kulturor dhe shpirtëror. Ky rend ushtarak për mentor shpirtëror kishte rendin e fuqishëm bektashi dhe disa tarikate të tjera *shiite*, që përfshinte një pjesë të madhe të popullatës. Andaj, nuk ishte e rastit që Reni i ri u ballafaqua me një fushatë të madhe e të pandërprerë për ta penguar atë, fushatë kjo që shkoi edhe deri te disa rebelime të njëjësive ushtarake, të përcjella edhe me rebelime.<sup>915</sup>

Në të vërtetë fushata për ta penguar Rendin e ri ushtarak, që e kishte shpallur Sulltan Selimi III, ishte përpjekje për luftë a vdekje e strukturave despotike-obskurantiste të vjetruara, të cilat me shformimin e rendit *spahij* dhe formimin e *qiflliqëve*, përfundimisht humbnin platformën mbi të cilët ata kishin qëndruar dhe kishin ngritur pushtetin e tyre të fuqishëm prej nga për mbi tre shekuj kishin drejtuar Perandorinë Osmane nga sukseset e mëdha e deri te ngecjet dhe dështimet e fundit, të cilat, po qe se do të vazhdonin të ruheshin, seriozisht rrezikonin themelet e saj. Këto struktura nuk ishin të gatshme për kurrfarë ndryshimesh, veçmas që të hiqnin dorë nga sistemi *spahi* i pronës, ku ata kishin mbështetjen kryesore, edhe pse ishte më se e qartë se shpërputhjet midis një shoqërie të së djeshmes dhe të sotmes ishin aq të mëdha dhe të dukshme, saqë rrezikohej një shembje e brendshme me pasoja të rënda jo vetëm për Perandorinë Osmane. Jeniçerët shfaqeshin si dega e tyre e fundi dhe e vetme ku ata mund të kapeshin, ani pse tashmë u kishte kaluar koha. Krenaria dhe lavdia e dikurshme jo vetëm që nuk u ndihmonte, por edhe e pengonte, meqë autoriteti qendror që e kishin ngritur kërkonte luftëtarë të tjerë, që i nënshtroheshin disiplinës ushtarake dhe mbikëqyrjes politike nga një qendër. Që të mos vinte te një revoltë e hapur e strukturave të vjetra, sulltani u tregua i kujdesshëm me reformat në ushtri. Sjelljen e ekspertëve të huaj (francezë dhe gjermanë) e arsyetoi me modernizimin e reparteve ushtarake dhe mobilizimin e tyre në përputhje me zhvillimet teknike. Kështu, nën drejtimin e oficerëve perëndimorë, formoi korpuset anekse: mortajat, minat, bartjen dhe të tjera, që i dhanë një pamje të re ushtrisë tradicionale. Pas këtij hapi, Sulltani Selimi shkoi edhe më tej në organizimin e ushtrisë, duke vendosur rendin e stërvitjes sipas mënyrës europiane nga ekspertët francezë, por edhe nga ata anglezë e gjermanë. Ekspertëve europianë iu lanë në dispozicion ushtarë të rinj të mbledhur nga pushtetarët dhe *ajanët* “provincialë”, kryesisht në pjesët e Anadollit. Në shtator 1794 ata u vendosën në Levend Çiflik, jashtë mureve të kryeqytetit dhe më 1801 numri i tyre kaloi në disa mijë. Një vit më vonë, në Anadoll u vu në fuqi një sistem i vërtetë rekrutimi që

---

<sup>915</sup> Po aty.

pas pak *Nizami xhedit* të numërojë rreth 22 mijë ushtarë dhe 1870 oficerë, nga të cilët gjysma ishin në Stamboll dhe gjysma tjetër në Anadoll.<sup>916</sup>

Ngritja e *Nizami-i xhedit-it* si dhe forcimi i tyre i shpejtë si korpus special, fuqia e të cilëve tashmë nuk varej nga qendra, por nga *ajanët* dhe *pashallarët*, krijoi një “shkas” tjetër jo vetëm për t’u kundërshtuar, por edhe për t’u luftuar ai bashkë me pakon e reformave shoqërore që shkonin me të, siç ishin ato të heqjes dorë të rendit të pronës *spahi* dhe kthimit të *çiflliqeve*.

Se jeniçerët dëshironin të mbesin në lëvozhgën e vjetër dhe të paprekshëm, kjo së pari dhe më së miri do të shihet kur ata, në vitin 1801, pra vetëm pak kohë pasi që Rendi i Ri të fillonte të ndërtohej, do të vrasin guvernatorin e pëlqyer të Pashallëkut të Beogradit, Haxhi Mustafën, mëkëmbësin besnik të Sulltanit reformator, me çka haptas do t’i shpallin luftë që të gjitha përpjekjeve për ndryshimin e gjendjes ku elita konservative Osmane në bashkëveprim me klerin fanatik islamik tregojë e papërfillshme ndaj çfarëdo ndryshimi, që ishte në frymën e të arriturave ekonomike dhe teknologjike, të cilat tashmë po ndodhnin në perandoritë tjera europiane dhe jashtë tyre nuk mund të rrihej. Me vrasjen e valiut të Beogradit dhe me zhvillimet që do të ngjajnë gjatë katër-pesë viteve të ardhshme në këtë Pashallëk të rëndësishëm të dominuar nga Serbët, mbase pa dashje, jeniçerët hapën një proces ta themi historik dhe të pandalshëm – atë të shpërthimit të lëvizjeve nacionaliste dhe separatiste në Ballkan, me ç’rast përpjekjet e Portës së Lartë për të vu në jetë reformat ushtarake në dobi të forcimit të autoritetit qendror dhe në luftë kundër despotizmit vendor, do të shfrytëzohen për shkëputje nga Perandoria Osmane.<sup>917</sup> Kjo për pasojë do të ketë edhe ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të fuqive të mëdha europiane në punët e Portës së Lartë, si një domosdoshmëri që ruajta e saj e mbikëqyrur njëherësh, që dihej se do ta çonte edhe deri te shembja, të bëhej në përputhje me ruajtjen e balancimeve midis tyre.

Pavarësisht këtyre zhvillimeve që vuri në veprim ky ndryshim si dhe reagi-meve që pasuan, u pa se jeniçerët e me të edhe strukturat e vjetra nuk ishin të gatshme të pranoin reformat ushtarake, shoqërore dhe politike. Kështu, nga viti 1801-1808 kemi një varg rebelimesh nga ana e jeniçerëve të cilat patën pasojë të rënda për vetë zhvillimet e brendshme shoqërore dhe politike të Perandorisë nga qërimi i hesapeve midis jeniçerëve dhe Rendit të ri ushtarak. Duke dëshiruar që t’u jepte fund luftërave të brendshme, por në dobi të Rendit të Ri ushtarak, sulltan Selimi në fillim të vitit 1805, vendosi të organizonte në Edrene një korpus të ri të

---

<sup>916</sup> Po aty.

<sup>917</sup> Po aty.



formuar në bazë të rekrutimit të përgjithshëm në Ballkan. Ajani i Ruçukut, Tirsanikli Oghulu u vu në krye të rezistencës: ai u bashkua me të gjithë feudalët e mëdhenj. Porta dërgoi një ushtri të komanduar nga Kadi pasha, kreu i *nizam-i xhedid-t*, jeniçerët e Edrenesë ngritën krye, me ç’rast paniku e mbërtheu edhe Stambollin dhe Selimi u desh të kapitullonte: veziri i madh dhe reformatorët u shkarkuan. Pak më vonë shënohet edhe një revoltë tjetër e jeniçerëve në kryeqytet. Sulltani u përpoq të shpëtonte fronin duke prishur *nizam-i xhedid-in* dhe duke ua dorëzuar krerët e tij kryengritësve. Ai u detyrua të mbyllej në kafazin e sarajit, me ç’rast i dha mundësi që kushëriri i tij, konservatori Mustafa IV të marrë fronin në maj të vitit 1807.<sup>918</sup>

Marrja e fronit nga sulltan Mustafa IV, disfata e Rendit të Ri Ushtarak nga i cili u hoq dorë dhe kthimi i jeniçerëve, megjithatë, nuk e rehatoi perandorinë, meqë ata tashmë nuk ishin të gatshëm as për luftë e as për paqe dhe si të tillë ishin kthyer në problem kryesor. Qëllimi i tyre ishte mbajtja në pushtet të strukturave që nuk mund të mbaheshin, gjë që në këto përpjekje ata sillnin shqetësim dhe turbullirë, që kërcënonte ta rrënonte perandorinë nga brenda, veçmas pas rebelimeve të disa pashallëqeve (atij të Egjiptit dhe të Janinës), ku fuqitë e mëdha filluan t’i fusin gishtat. Kjo bëri që sërish të dalin në skenë “mbetjet” e *nizam-i xhedid-it* nga Ruçuku, me ç’rast Mustafa Bajraktari, pasi që kishte zënë vendin e Tirsanakli Ogluit të vvarë, mbledhi një ushtri “vullnetarësh” prej 30 mijë vetash, të cilët kërkuan kthimin në fron të Selimit. Ata hynë në kryeqytet në korrik të vitit 1808. Të nesërmen vendosën në fron një nip të Selimit që i shpëtoi vrasjes – Mahmutin II (1808-1839).

## REBELIMI I PASHALLARËVE SHQIPTARË – BUSHATLINJVE DHE ALI PASHË TEPELENËS

Vendosja e sulltan Mahumtit në fron, njëherësh shtroi domosdonë e vazhdimit të reformave ushtarake në përputhje me modelin e *nizam-it xhedid*, që kishte pësuar një disfatë nga jeniçerët dhe konservatorët, por edhe më tutje mbetej e vetmja forcë vepruese. *Ajanët* e Bajraktarit që shfaqeshin si forcë përparimtare ushtarake, megjithatë, nuk mund të ishin zgjidhja e problemit, ngaqë ata duhej t’i nënshtroheshin një urdhri qendror dhe komande të përbashkët në përputhje me modelet e reja ushtarake. Duke parë këtë gjendje, Sulltani bindi Bajraktarin që *ajanët* e Rumelisë

---

<sup>918</sup> Po aty, faqe 248.

të shfaqeshin si bërthamë e një korpusi të ri, të quajtur *sejmenë*, në krahë të trupave tradicionalë. Me këtë rikthehej *nizam-i xhedid-i*, por me një emër tjetër.<sup>919</sup>

Edhe ky vendim u kundërshtua nga jeniçerët. Ata u hodhën në luftë edhe kundër *sejmenëve*, duke u mbështetur serish te ulemaja konservatore e cila frymëzohej nga nëna Valide e sulltan Mustafait. Po atë vit, jeniçerët edhe një herë ngritën krye dhe u bënë zot të kryeqytetit. Veziri i madh bëri vetëvrasje, ndërsa Mahmuti II nuk bërë asgjë për të shpëtuar vezirin e tij të madh, por pa se deri ku shkonte rezistenca kundër reformave. Kundruall atyre rrethanave, Sulltani Mahmuti II, i cili nuk kishte rrugë tjetër pos të vazhdonte reformat e nisura nga Selimi, lejoi strukturat e vjetra ushtarake të vepronin, por duke i përçarë mes veti me anën e privilegjeve të ndryshme, ndërkohë që *sejmenëve*, që shfaqeshin në përbërje të Rendit të Ri Ushtarak u kushtoi vëmendje të veçantë.

Sulltani reformator, për ta zbutur revoltën e paralajmëruar të jeniçerëve, joshi disa prej tyre për Rendin e ri, duke u premtuar grada të larta në hierarkinë e re ushtarake, ndërkohë që urdhrit ia hoq ushqimin shpirtëror që kishin që nga koha e themelimit – mbikëqyrjen e bektashizmit. Krahas kësaj, me lejimin e krijimit të familjeve, pra të martesës dhe të pronës, jeniçerëve po ashtu iu hoq faktori i fanatizmit të zanatit të tyre prej ushtaraku me të cilin ata ishin kthyer në gardë elite perandorake dhe kishin meritat më të mëdha për sukseset e saj ushtarake në shekujt XV-XVII. Në këtë shkërmoqe të jeniçerëve rol të dukshëm do të luajnë edhe privilegjet ekonomike dhe politike që iu dhanë disa prej tyre, me ç’rast ideali i ushtarakut u zëvendësua me atë të pasurisë dhe të pozitës shoqërore me çka kulti i tyre filloi të bjerë dukshëm bashkë me respektin që gëzonin.

Shembulli i privilegjeve në kuadër të sofrës perandorake, për jeniçerët do të ndikojë rrënueshëm në periferi, pikërisht ku ata kishin autoritet të madh dhe atë më së shumti e shfrytëzonin strukturat vendore, meqë shumë prej tyre, kundërvënien pushtetit qendror, do ta zëvendësojnë me gjetjen e gjuhës së përbashkët me këto struktura. Ato po ashtu shiheshin të rrezikuara nga reformat perandorake, të cilët tashmë kishin filluar të bishtnonin autoritetin e Sulltanit në dobi të forcimit të feudeve të tyre sa edhe atë ta përjashtonin fare, siç do të jetë rasti me Kara Mahmut Pashën e Shkodrës, Osman Pasha Pazvanogllun e Vidinit dhe Ali Pashën e Janinës.<sup>920</sup>

Ky zhvillim, pra i kapjes në valle të përbashkët i jeniçerëve në ambiciet e pashallarëve despotikë që të kundërshtojnë pushtetin e Sulltanit drejt krijimit të

---

<sup>919</sup> Po aty, faqe 249.

<sup>920</sup> Birge, John Kingsley: “Urdhri Bektashi i dervishëve”, Tiranë 2008; Schwartz, Stephen: “Islami tjetër”, Prishtinë 2009.

pashallëqeve të pavarura, Sulltan Selimin III dhe më vonë pasardhësin e tij Sulltan Mahmutin II do ta detyrojnë që luftën kundër jeniçerëve ta lidhin me rrënimin e pashallëqeve të rebeluara, në radhë të parë me atë të Pashallëkut të Shkodrës të drejtuar nga Bushatlinjtë dhe atë të Vidinit nga Pazvanogllu për të kaluar së fundi tek Ali Pashë Tepelena i Janinës.

Për Perandorinë Osmane pashallëqet shqiptare shfaqnin shqetësim të veçantë, sepse lidheshin me një hapësirë strategjike si për të, për t'u mbrojtur nga kundërshtarët, por edhe për kundërshtarët e Portës, që me anën e tyre të dobësonin apo edhe ta destabilizonin atë, siç do të veprohej herë pas herë dhe në përputhje me interesat e tyre nga ana e Austro-Hungarisë, Ruisë, Francës po edhe Anglisë nga fundet e shekullit të tetëmbëdhjetë dhe fillimet e shekullit të nëntëmbëdhjetë. Andaj, është me interes të thuhet se ngritja dhe rënia, pra forcimi dhe rrënimi i këtyre Pashallëqeve, (Shkodrës, Vidinit dhe Janinës), paraqesin uverturën e gjatë të ballafaqimit të brendshëm të Perandorisë Osmane me strukturat feudalo-despotike, mbi të cilat gjatë kohë ishte mbështetur, por që një ditë duhej qeruar hesapet me to pse duke u forcuar dhe pavarësuar, rrezikonin autoritetin qendror. Por, meqë pushteti i brendshëm ishte çështje e mentaliteteve që mbështeteshin mbi logjikën e më të fortit, që jo rrallë ishte i dobishëm për heqjen e ngulfatjeve që krijoheshin nga autoritetet vendore, Perandoria Osmane kishte interes që tek pashallëqet shqiptare, për arsye strategjike, në raste të caktuara këto struktura të ruheshin dhe madje edhe të forcoheshin. Bëhet e ditur se mbi këtë qëndrim Perandoria do të refuzojë t'i mbrojë disa nga sanxhakbejtë e emëruar prej saj, siç ishte rasti me atë të Ohrit, të Durrësit dhe të Beratit, kur ata do të sulmohen nga Mehmet Pasha dhe më vonë Mahmut Pashë Bushatliu i Shkodrës, apo feudalët vendorë në Rumeli që kur Pazvanogllu do t'i fusë dhunshëm nën mbikëqyrje. Në disa raste Ali Pashë Tepelena në mënyra të ndryshme do të jetë nxitur nga vetë Porta që t'i përvetësojë disa nga sanxhaqet për t'ia bashkuar Pashallëkut të Janinës. Konfrontimet me Portën do të lindin atëherë, kur Pashallarët do të fillojnë të rrallojnë taksat qendrës, t'i pakësojnë njëanshëm apo kur do t'i ndalin fare, siç do të jetë me rastin e Pazvanogllut, dhe ai do të shpallet i pavarur nga Perandoria, dhe siç do të veprojë një kohë edhe Mahmut Pashë Bushatliu, pasi që do të hyjë në disa lidhje të pasuksesshme fillimisht me Rusët dhe më vonë me Austro-Hungarezët, duke deklaruar se ato i duheshin për mbajtjen e ushtrisë së Pashallëkut.<sup>921</sup>

---

<sup>921</sup> Shih: "The Life of Ali Pascha of Janina, late vizir of Epirus", London 1823; Boppe, A. "Napoleoni dhe Ali Pasha", Tiranë 1999; Skendi, Stavro: "Zgjimi kombëtar shqiptar", Tiranë 2000; "Historia e popullit shqiptar", I, Tiranë 2002.

Sulltan Selimi III dhe më vonë pasardhësit e tij Mustafai IV dhe Mahmuti II – dhe ky i fundit do të jetë vendimtari që do t’i qërojë hesapet me jeniçerët dhe urdhurin e tyre në vitin 1826, kur krahas shpërndarjes do të fillojë edhe luftën kundër rendit bektashi, që merreshin për mbrojtës shpirtëror të tyre.<sup>922</sup> Shkas për ndërhyrje të hapura luftarake ndaj Pashallarëve kryengritës, sulltani do ta ketë pikërisht mbështetjen që ata ua jepnin jeniçerëve dhe përdorimi i tyre për t’u luftuar përpjekjet e Perandorisë për t’i kryer reformat në armatë si dhe modernizmin e saj, të cilat ishin përcaktuese për fatin e saj të mëtutjeshëm. Kështu, Pashai kryengritës i Vidinit (Pazvanogllu), fillimisht do të shërbejë në ushtrinë perandorake gjatë luftës austro-turke të viteve 1789-92 dhe më pas u kthye në Vidin, me bindjen se atë do të rikthente pasurinë familjare, po edhe një Pashallëk, i cili do të ishte me ndikim në një nyjë të rëndësishme që lidhte pjesën e Perandorisë Osmane me Perëndimin. Me pretendimet se duhej që të tubonte rreth vetes forca të caktuara ushtarake jashtë mbikëqyrjes perandorake, brenda një viti do të ngre një ushtri kusarësh me jeniçerë dhe me të pakënaqur nga gjiri i trupave perandorake, të cilat kishin filluar të tregonin shenja të qarta të anarkisë. Kur guvernatori i Vidinit, besnik ndaj Sulltan Selimit, dërgoi trupa për t’i dhënë fund zullumeve të tij, ai i shpartalloi ato pa ndonjë mund të madh.<sup>923</sup>

Me t’u forcuar edhe më tutje me trupa të ndryshme nga repartet e shkëputura të jeniçerëve nga pjesë të ndryshme të Perandorisë, dhe veçmas me *kerxhali*jtë e pamëshirshëm për zullume, Pasha i Vidinit, në vitin 1795 shpalli pavarësinë nga Sulltani.<sup>924</sup>

Qe ky rasti i parë i deklarimit të shkëputjes së një pashallëku nga pjesët europiane nga Porta e Lartë. Ai do të përcillet me veprime të ngjashme apo të një

---

<sup>922</sup> *Bektashinjtë* u shfaqën së pari në formën e një urdhri dervishësh në pjesën aziatike të Perandorisë Osmane (Anadoll). Themeluesi dhe mbrojtësi i këtij urdhri mistik ishte Haxhi Bektashi, i lindur në Iran më 1224 dhe i vendosur në Turqi më 1284. Rol të veçantë në ngjizjen e ideve të Haxhi Bektashit patën kontaktet e tij me besimet aziatike të budizmit dhe të hinduizmit gjatë udhëtimeve që ai kreu në Indi, Tibet dhe Kinë. Bektashinjtë gjetën vend në Ballkan dhe veçmas në hapësirën shqiptare, ku u pranuan dhe u shtrinë thuajse në të gjitha pjesët e vendit. Vlerësohet se mësimet e tyre joshën një pjesë të mirë të Shqiptarëve që të pranojnë islamizmin jashtë dogmës. Ata, madje, në kohën e zgjimit kombëtar, u kthyen në militant të nacionalizmit shqiptar. Më gjerësisht rreth Bektashinjve të Shqiptarët shih: Schwartz, Stephen: “*Islami tjetër – Sufizmi dhe rrefimi për respektin*”, Prishtinë, 2009; Schwartz, Stephen: “*Bektashizmi si model Universal*”, Tiranë, 2003; Schwartz, Stephen: “*Two Books on Bektashi Islam in Albania*”, botuar në “*Albanian Catholic Bulletin*”, Tiranë, 1991; Rexhepagiqi, Jashar: “*Dervishët dhe teqetë në Kosovë, në Sanxhak dhe rajonet tjera përreth*”, Pejë, 2003.

<sup>923</sup> Shih Glen, Misha “*Historia e Ballkanit 1804-1999*”, Tiranë, faqe 5.

<sup>924</sup> *Kërshalinjtë të quajtur edhe gërshalinjtë* – ishin kusarë nomadë, që viheshin në shërbim të atij që u jepte më shumë. Këta plaçkitës ishin shumë të kërkuar në Serbi, Bosnje, po edhe në Hungari, meqë ata jo rrallë përdorshin për ta dobësuar autoritetin e pushtetit qendror. Trupa të tilla, Serbët përdorën gjatë kryengritjes së dytë, por ata do të shihen edhe në Greqi gjatë luftës së vitit 1922-1930.

natyre të njëjtë, siç ishte rasti i Kara Mahmut Pashë Bushatit nga Shkodra në vitin 1796 dhe Ali Pashë Tepelenës së Janinës në vitin 1822.

Sulltan Selimi III nuk do ta presë gjithaq i shqetësuar këtë veprim, meqë ishte i bindur se kjo do t'i shërbente si shkas i mirë që njëherësh t'i qëronte hesapet me pashallarët e pabindur dhe me jeniçerët, veçmas me këta të fundit, që tashmë i shihnte si kundërshtarët kryesorë drejt reformave. Por, çastin që ushtria e tij po bëhej gati që të shkonte për në Vidin, gjërat do të marrin një kah thuajse tjetër, meqë ishte Napolon Bonaparti me sulmin në Egjipt që ia ndaloi për pak rrugën.<sup>925</sup>

Përgjigjja që duhej dhënë Napolonit kishte rëndësi të madhe, meqë aktet e tilla tashmë nxirrnin në pah rolin e faktorit të brendshëm, pra të lëvizjeve autonome, të cilat mund t'i jepnin frymë shpërbërjes së Perandorisë nga brenda, si dhe përdorimin e tyre nga jashtë, pa marrë parasysh deklaratimet formale të fuqive të mëdha rreth respektimit të tërësisë territoriale të saj si dhe *status quo*-s, në përputhje me vendimet e Konferencës së Paqes të Parisit të vitit 1865, gjendje kjo që do të pranohet edhe nga Kongresi i Berlinit dhe do të vazhdojë deri tek shembja e saj.<sup>926</sup>

Se fuqitë e mëdha të kohës tashmë kishin filluar të luanin lojën e tyre të shembjes së Perandorisë nga brenda, përkundër deklaratimit të përkrahjes, kjo do të shihet më së miri me rastin e Pashës së Vidinit, i cili këtë lëvizje nuk do ta bënte pa qenë i udhëzuar nga kundërshtarët e Perandorisë Osmane, (Rusia dhe Austro-Hungaria), të cilët deri më dje ishin në luftë me të dhe përkundër nënshkrimit të marrëveshjeve të paqes, edhe më tutje kërkonin forca nga brenda me të cilat do të dobësohej Perandoria. Në përputhje me këtë prirje, Pasha i Vidinit madje kërkoi që të lidhej me Rusinë dhe vendet tjera ortodokse, në mënyrë që t'i forconte pozitat. Kërkesë të ngjashme nisi edhe për në Vjenë, por si do të shihet, sapo Perandoria të shuajë kryengritjen serbe, do t'i kthehet me shumë ashpërsi dhe do ta rrënojë.<sup>927</sup>

Thuajse në të njëjtën kohë dhe me të njëjtat metoda do të veprojnë edhe Bushatlinjtë e Shkodrës, të cilët hesapet me refuzimin e reformave perandorake që ua rrezikonte feudet do ta lidhin edhe me hyrjen në lojëra me faktorët e jashtëm, ani pse, si do të shihet, përherë do të mbesin me gishta në gojë, ngaqë fuqitë e mëdha (Austro-Hungaria dhe Rusia), kërkonin “trazues” në Arnautlluk, por assesi, që përfitues të dilnin ata. Kështu, fillimisht do të jetë Mehmet Pasha dhe më vonë i biri i tij, Mahmut Pasha, të cilët do të ngrihen me një shpejtësi në fron duke përthithur

<sup>925</sup> Glenny, Misha: “*Historia e Ballkanit 1804-1999*”, Tiranë, 2007, faqe 5; Skendi, Stavro: “*Zgjidhje kombëtare shqiptare*”, Tiranë 2000, faqe 29-30; Boue, Ami: “*Shqipëria në Turqinë Europiane*”, Tiranë, faqe 103-108.

<sup>926</sup> Më gjerësisht rreth gjendjes së *status quo*-s në pjesën europiane të Perandorisë Osmane shih Buxhovi, Jusuf: “*Kongresi i Berlinit 1878*”, Prishtinë, 2008, Protokollat dhe vendimet, faqe 95-262.

<sup>927</sup> Më gjerësisht shih Castellan, Georges: “*Histori e Ballkanit*”, Tiranë 1991, faqe 257-263.

rreth vete një fuqi të madhe, e cila Pashallëkun e Shkodrës, për ndryshim të atij të Vidinit, që ishte në afërsi të Stambollit dhe gjeografikisht nuk kishte rëndësinë e pashallëkut shqiptar, do ta kthejë në qendër të vëmendjes edhe nga jashtë, veçmas pasi dihehin pretendimet e Austro-Hungarisë ndaj Bosnjës, ato të Francës ndaj bregdetit Adriatik dhe të Rusisë ndaj faktorit ortodoks (atij malazias dhe serb) si dhe instrumentalizimit për qëllime hegjemoniste, që u vunë në veprim pas pak.

Fillimisht do të jetë lufta e Perandorisë Osmane me Rusinë dhe Austro-Hungarinë e viteve 1789-92 dhe pastaj ajo me Napolonin si dhe rasti i Malit të Zi, si kartë e re që po futej në pokerin e Fuqive të Mëdha, që Pashallëku i Shkodrës do t'ia rrisin rëndësinë karshi Perandorisë, po edhe nga të tjerët që ishin në konflikt me të, ose që pretendonin të nxirrnin përfitime nga lojërat e tërthorta. Në këto rrethana Mahmut Pasha, i cili i kthyer në një pashë të fuqishëm, do të mendojë se mund t'ia dalë që të përfitojë me anën e marrëveshjeve të drejtpërdrejta me kundërshtarët e Portës, fillimisht me Rusinë e pastaj edhe me Austro-Hungarinë dhe Francën, lojëra këto, që ajo e fundit me Francezët do t'i kushtojë me kokë. Kështu, në maj të vitit 1788 Mahmut Pasha u takua në kështjellën e Rozafës me një përfaqësues të ambasadorit rus në Venedik. Në këtë takim Bushatlliu pranoi të vazhdonte kryengritjen kundër “armikut të përbashkët” dhe u zotua të lehtësonte hyrjen e trupave ruse në Stamboll, duke pushtuar Shqipërinë deri në Manastir e një pjesë të Maqedonisë deri në Selanik.<sup>928</sup>

Për këtë pjesëmarrjeje në luftë, ai kërkoi t'i jepej një shumë të hollash për të bërë për vete pashallarët shqiptarë dhe të dërgohej në bregdet një skuadër anijesh luftarake për të kërcënuar ose, po të jetë nevoja, për të bombarduar ato qytete që do të mbanin anën e Portës.<sup>929</sup>

Duke parë se Ruset kishin hesapet e veta dhe ata mund ta mbanin për laku, Bushatlliu denjoi që ngjashëm të vepronte edhe me Vjenën, mos kjo do t'ia shtonte pazarin hesapit që kërkonte nga ata që ndodheshin në luftë me Perandorinë Osmane. Madje, thuhet se, me kërkesën e Pashait të Shkodrës drejtuar Vjenës, nëpërmjet kryepeshkopit të Tivarit, Gjergj Radovani, oborri i monarkisë kishte dërguar në Shkodër përfaqësuesin e vet, që do të merrej me mundësinë që Mahmut Pasha të merrte anën e tyre në luftë kundër Portës në formën e një aleance me forcat fqinje.<sup>930</sup>

---

<sup>928</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, Pjesa e parë, Tiranë, 2002, faqe 627; Skendi, Stavro: “Zgjidimi kombëtar shqiptar”, Tiranë 2000, faqe 29.

<sup>929</sup> Shih “*Historia e Popullit shqiptar*”, I, Tiranë, 2002, faqe 627.

<sup>930</sup> Po aty, faqe 627.

Por, Vjena dhe Rusia nuk do të kenë nevojë për ndihmën e Pashait të Shkodrës, sepse në janar të vitit 1792, për t'i dalë përpara rrezikut të ri që po u vinte nga Franca dhe Bonaparti, nënshkruan traktatin e paqes me Perandorinë Osmane. Tona pajtuese për momentin Mahmut Pashës do t'i vijë edhe nga Sulltan Selimi III, i cili e dinte se Pashallëku i fuqishëm i Shkodrës do t'i duhej përherë si një pikë e rëndësishme në një skaj të pjesës europiane të Perandorisë për të mbikëqyrur zhvillimet në Bosnje dhe në Mal të Zi. Andaj, vendosi që ta gradojë vezir, ndërkohë që edhe i vëllai, Ibrahim u gradua Pasha dhe iu lejua edhe qeverisja e sanxhakut të Ohrit dhe atij të Elbasanit.

Duket se Pashai i Shkodrës, peshqeshet nga Stambolli, nuk i kuptoi ashtu si duhej. Pasi që Sulltan Selimi III me anën e "*Nizam-i-xhedid-it*" t'i ketë shpallur planet për reformimin e ushtrisë perandorake, i shtyrë nga ulematë, nga feudalët e çifligarët, dhe i bindur se duke u mbështetur në forcën e jeniçerëve, që ishin më të kërcënuarit me reformën e ushtarake të Sulltanit, Mahmut Pasha, dha shenjat e para të një kryengritjeje të dytë kundër Sulltan Selimit III dhe reformave të tij.<sup>931</sup>

Natyrisht, se edhe këtë herë, krahas forcave të brendshme që ishin kundër çfarëdo ndryshimi në strukturën e ndryshkur perandorake, Mahmut Pasha i drejtoi sytë kah kundërshtarët e Portës. Vendin e pakmëparshëm të Rusisë dhe të Austro-Hungarisë, me të cilat kishte filluar hesape të caktuara në dobi të forcimit të mëtutjeshëm, tash e zinte Franca dhe politika e saj e shtrirjes në Adriatik dhe Mesdhe. Do të jetë ambasadori i gjeneral Bonapartit në Venedik, i cili pas nënshtrimit të Italisë Veriore në maj të vitit 1796, parashihte që të pushtonte edhe Dalmacinë, trimëri pashën e Shkodrës që të futej në luftë kundër Malit të Zi dhe ta fuste nën ombrellën e Pashallëkut të Shkodrës. Madje, për këtë u ndihmua me të holla dhe ushtarakisht (me specialistë, që duhej ta ndihmonin modernizimin e forcave të tij ushtarake për këtë ekspeditë), pa çarë kokën se ashtu i hapte vetes telashe me Rusinë, si mbrojtëse e vendeve sllavo-ortodokse, po edhe me Austro-Hungarisë, e cila nuk do të lejonte kurrsesi një aleat francez në afërsi të Bosnjës.<sup>932</sup>

Trimërimi francez i Malit të Zi do të jetë vendimtar që Mahmut Pasha të niset për në fushatë kundër Cetinës. Në korrik të vitit 1796, futet në krahinat e malësisë shqiptare për t'i nënshtruar ato dhe për të shkuar më tutje. Por, si do të shihet, nuk do t'ia dalë, meqë atje hasi në një rezistencë të fuqishme, që nuk e kishte pritur. Në shtator, serish do të përsërit sulmin, me ç'rast në një pusi që i ishte vënë, vritet nga Malazezët dhe me këtë do të marrë fund ëndrra e tij për një Pashallëk të pavarur

---

<sup>931</sup> Po aty, faqe 628.

<sup>932</sup> Po aty, faqe 629.

nga Perandoria Osmane, i cili nuk projektohej si një zhvillimi i brendshëm dhe në përputhje me reformat, por në një kah të kundërt: duke u mbështetur tek strukturat e vjetra feudale dhe të atyre të obskurantizmit fetar, të cilat ishin në kundërshtim me kohën. Përpjekjet që të mbështetej nga jashtë, duke kërkuar që të luante në lojën e atyre që kishin interesa që ta dobësonin Perandorisë Osmane nga brenda, po ashtu do të tregohen të padobishme madje, nga shkaku i thjeshtë se asnjëra nga Fuqitë e Mëdha të cilat flirtonin me të, nuk ishin të gatshme që në ato rrethana të pranonin animimin e faktorit shqiptar, veçmas kur ai shfaqej me fuqinë e subjektivitetit etnik në një hapësirë ku secila kishte hesapet e veta.

Pak a shumë, fat të njëjtë do të ketë edhe Pashallëku i Janinës dhe Ali Pashë Tepelena, i cili filloi të ngrihet çastet që Pashës së Shkodrës do t'i shuhet ylli në fikjen e të cilit do të ndjehet edhe dora e tij. "*Luani i Janinës*" jo vetëm që nuk mësoi nga "*Ujku i Shkodrës*", por shkoi të njëjtës rrugë, përsëriti të njëjtat metoda për të zgjeruar pushtetin (rëndom duke u mbështetur te jeniçerët dhe forcat tjera ushtarake në shturje e sipër dhe duke rrënuar fuqinë e brendshme të feudalëve dhe të parisë vendore) dhe, provoi të hyjë të njëjtave lojëra me fuqitë e jashtme në mënyrë që në fund, kur t'i shpenzohen të gjitha kartat dhe të shohë se nuk ka qenë në gjendje që t'u bëjë ballë atyre, veçmas kur do të ballafaqohet me kundërpërgjigjen e fuqishme perandorake, të mbetet i vetmuar kundër saj, duke bërë që t'i mbetet lavdia si ngushëllim kundruall një fundi me pasoja të rënda për veten dhe përfitime për të tjerët, sidomos për Grekët. Kështu, edhe Pasha i Janinës, filloi ta grumbullojë pushtetin duke rrënuar feudet e vogla dhe të mesme, të cilat, me taksa dhe pengesa të ndryshme për qëllime përfitimesh, kishin filluar të ngulfatnin frymëmarrjen e tregtisë dhe të qarkullimeve të mallrave në përmasa më të gjëra. Ato veprime të Ali Pashë Tepelenës, nuk do të kundërshtohen nga Porta edhe atëherë kur ato kryheshin me metoda tejet të dhunshme, ku jo rrallë binin pre mëkëmbësit që emëronte Sulltani.

Pas telasheve që kishte pasur me Pashallëkun e Shkodrës, Perandoria Osmane vlerësonte se forcimi i Pashallëkut të Janinës do të ishte i dobishëm, që të ruante baraspeshën e forcës nga veriu dhe jugu, në një pikë tejet të ndjeshme prej nga do të mund të mbikëqyreshin zhvillimet në Mal të Zi dhe veçmas në Bosnje, po edhe ato në jug, ku ishte më se e qartë se Grekët do të ndiqnin shembullin e Serbëve, të cilët pas dy kryengritjeve (asaj të vitit 1804 dhe 1815) kishin fituar autonominë. Siç do të veprohet fillimisht me Mahmut Pashë Bushatin, kur do t'i jepet grada e vezirit që të lidhej për vete kur ai kishte filluar të luante bisht me Rusët dhe Austro-Hungarezët, Porta e Lartë, Pashës së Janinës ia dha gradën e vezirit në vitin



1799 pasi ai mori pjesë në luftë kundër forcave franceze, me ç'rast atyre do t'u merret Butrinti, Preveza dhe Vonica.<sup>933</sup>

Pasha i Janinës, megjithatë, shfaqej i pakënaqur me këtë gradim dhe madje atë e pa si prapaskenë të Sulltanit, pasi që qytetet bregdetare që ua kishte marrë Francezëve me luftë, u detyrua t'i kthejë në mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të Portës së Lartë me ç'rast ajo po hynte edhe në disa lojëra me Rusët, siç ishte marrëveshja ruse-osmane e vitit 1800, me të cilinë ishte krijuar e ashtuquajtura Republikë e Shtatë Ishujve, me çka do të sanksionohet vendosja e Ruisë në ishujt jonianë. Meqë rrethanat ndërkombëtare si dhe zhvillimet e asokohshme në to, në dhjetëvjetëshin e parë të shekullit nëntëmbëdhjetë, ishin të përshkuara nga sjellja e Francezëve për depërtime sa më të mëdha në Lindje dhe në Jug si dhe nga aleancat e shumta dhe të shpeshta që t'i ndalej rruga Napolon Bonapartit, Ali Pasha do të vlerësojë se përfshirja e tij në këto lojëra mund t'i siguronte përfitime të shumanshme. SikundërMahmut Pashë Bushati dikur, Ali Pasha filloi të kërkojë aleanca në anë të ndryshme, por që këto duhej të ishin të përmasave shumë më të mëdha dhe të një koherence më të gjatë, që ndonëse në të gjitha do të dështojë, në çaste të caktuara, e kthyen në faktor të rëndësishëm, të shumtën për përdorime të përkohshme dhe lojëra në dobi të të tjerëve.

Nga ky aspekt, rëndësi të madhe patën lidhjet e tij me Anglinë, të cilat u kushtëzuan me largimin nga Franca dhe përkrahjen që do t'i jepet luftës kundër Bonapartit dhe më vonë edhe kundër Ruisë. Ndonëse nuk do t'i sjellin ndonjë dobi politike, megjithatë ato do të jenë të vlefshme, sepse në saje të miqësisë me disa nga krijuesit dhe personalitetet e njohura të kohës, që pati Pashai i Janinës, në opinionin anglez po edhe atë europian, do të dëgjohet të flitet për Shqiptarët dhe Shqipërinë si për një "margaritar" ekzotik në Ballkan me rrënjë të vjetra europiane dhe të ngjashme. Poeti i madh, Xhorxh Bajron, i cili do të qëndrojë një kohë te mirë në Janinë dhe prej andej madje, në ndjekje të kryengritjeve antiosmane të Shqiptarëve dhe të Grekëve, do të vdesë në Misolongji në vitin 1824 nga tuberkulozi, që ndër të parët që me tone romantike pasqyroi botën shqiptare si dhe atë që ndjeu për pashën e Janinës dhe fuqinë e tij.<sup>934</sup>

I futur në këtë vorbull, Ali Pasha, mësoi dredhitë, lajkat, por edhe fuqinë e veprimit të çastit, që shumtën do t'i shfrytëzojë për ngritjen e pushtetit të brend-

---

<sup>933</sup> Më gjerësisht shih: *"The Life of Ali Pascha of Jannina, late Vizier of Epirus"*, London 1823; Boppe, August: *"Napoloni dhe Ali Pasha"*, Tiranë 1999; Bue, Amin *"Shqipëria"*, Tiranë; *"Historia e Popullit Shqiptar"*, I, Tiranë 2002, faqe 643.

<sup>934</sup> Shih Byron, Georg Gordon (Lord Byron): *"Childe Harold's Pilgrimage"*, London, 1812.

shëm dhe të despotizmit deri tek tirania, por jo edhe tek arritja e ndonjë qëllimi historik. Sepse, lidhjet dhe takimet me jashtë, Pasha i Janinës do të dalë që t'i shfrytëzojë për zgjerimin dhe forcimin e pushtetit të brendshëm, i cili të shumtën nëpërmes intrigave, kurtheve dhe tiranive kundër rivalëve (pashallarëve të Beratit, Delvinës, Elbasanit e deri tek Shkodra). Kësaj sjellje, një çmim të madh do t'ia paguajnë Suli dhe suljotët, bashkë me Himarën dhe himarjotët, që si popullatë kompakte shqiptare, e cila për më shumë se tre shekuj kishte ruajtur autonominë e brendshme, do t'u rrënohet qenësia etnike. Kjo madje do të bëjë, që edhe kur do të fillojë ekspedita përfundimtare e Portës së Lartë kundër tij gjatë vitit 1822, të mbetet thuajse i vetmuar, i tradhtuar edhe nga të bijtë, që do t'i dorëzohen Sulltanit dhe do të futen në shërbim të tij.

Megjithatë, ngritja dhe rënia e Pashallëkut të Janinës, në atë që do të paraqesë parakusht për fillimin e zbatimit të Reformave të Tanzimatit (rrënimi i rendit të jeniçerëve dhe rrënimi i pashallëqeve që rrezikonin autoritetin qendror të Portës në dobi të ruajtjes së strukturave të vjetra të ndryshkura feudale), kishte edhe diçka të veçantë, meqë vinte në pah fuqinë e faktorit shqiptar në Perandorinë Osmane në përmasat e tyre etnike, e cila gjatë katër shekujve kishte ruajtur tërësinë dhe madje e kishte shtuar dukshëm. Kështu që ajo që deri më atëherë nga ana e Portës trajtohej si gjeografi e caktuar etnike shqiptare, që për t'u vënë në binarët e një peshe dhe rëndësie të përfillshme (autonomia), do t'i nevojiten konceptet e qarta politike, nxiti daljen në pah të "*Megali-idesë*" greke dhe "*Naçertanjes*" së Garashanit, me ç'rast, e para do t'ia hapë rrugën ekspansionizmit të njohur grek, ndërsa e dyta autonomisë së Serbisë dhe krijimit të programit nacional serb, mbi të cilin do të ndërtohet koncepti hegjemonist serbomadhi, i cili më së shumti do të fokusohet tek hapësira etnike shqiptare dhe qëllimet e njohura pushtuese ndaj saj. Kështu që, edhe zgjimi kombëtar shqiptar, si nevojë e veprimit të përbashkët dhe programet politike, që pak më vonë do të dalin prej tij, janë të lidhur ngushtë me ngjarjet që do t'u paraprijnë Reformave të Tanzimatit (fjala është për shpalljen e "*Nizam-i Xhedit-in*" e vitit 1794 nga Sulltan Selimi III si dhe pasojat që do të prodhojnë ato, veçmas lufta kundër rendit të jeniçerëve dhe qërimi i hesapeve me pashallëqet e rebeluar të Shkodrës, Vidinit dhe Janinës). Ky proces, po ashtu, pashmangshëm do të ndikohet edhe nga zhvillimet që do të sjellin kryengritja e parë dhe e dytë serbe, autonomia e Serbisë si dhe pavarësia e Greqisë në vitin 1830.<sup>935</sup>

---

<sup>935</sup> Conrad Malte-Brun: "*Për Shqipërinë dhe Shqiptarët*", Tiranë, faqe 171-226; Boppe, August: "*Napoloni dhe Ali Pasha*", Tiranë.

## AUTONOMIA E SERBISË, PAVARËSIA E GREQISË DHE NXJERRJA NË PAH E ÇËSHTJES SHQIPTARE

Është thënë shpesh se duhej të ishte e ashtuquajtura “shpërngulje e madhe serbe” nga Kosova e viteve 1690, e cila do të ketë ndikuar që nga kjo popullatë e “marrë në mbrojtje nga Perandori Leopold I”, në pjesën midis Savës dhe Dravës dhe midis Danubit dhe Tisës të jetë formuar një “*Serbi hungareze*”, ani pse zemra e saj, me selinë e mitropolisë në Karlovc të Sremit dhe qendrën tregtare dhe intelektuale në Nojzac (Neusatz- Novi Sad), kahmot gjendej në atë pjesë. Thuhet, po ashtu, se Perandori iu kishte garantuar nënshtetasve të tij të rinj lirinë e fesë dhe një vetadministrim të kishës së tyre, që paraqiste mjaft ngjashmëri me sistemin e *miletit* në Perandorisë Osmane.<sup>936</sup>

Se përtej lumenjve Savë-Danub gjithandej Vojvodinës hungareze ka ekzistuar një “*Serbi hungareze*”, e cila në shekullin XVIII do të shfaqet me bërthamën e një borgjezie të vogël serbe, që më 1790 themeloi një lice serb në Karllovci dhe u pasua nga një tjetër në Neuzac (Nojzac – Novi Sad), zhvillim ky intelektual që po atë kohë do të shoqërohet edhe me daljen e një gazete në gjuhën serbe në Vjenë, kjo është më se e vërtetë. Kësaj të vërtete, po ashtu mund t’i shtohet edhe një tjetër, që ka të bëjë me rolin e kishës ortodokse si mbrojtëse shpirtërore por edhe orientues politik dhe shoqëror, rreth së cilës Serbët përherë kishin shtrënguar radhët për t’i bërë ballë të gjitha përpjekjeve të hierarkisë katolike-hungareze për t’u tërhequr në uniatizëm.

Këto dhe të dhëna të ngjashme rreth shfaqjes së etnisë serbe në Hungari si dhe institucioneve të tyre shpirtërore e kulturore (kishës) e deri te vetëqeverisja dhe autonomia vendore (me këtë rast nuk duhet harruar edhe shtresën e sllavëve nga mesjeta e këndej, që u përfshi në “kufirin ushtarak” në Kraina – Kroaci me një traditë dyshekullore), jo vetëm që nuk i japin të drejtë pohimit se ishte e ashtuquajtura “shpërngulje e madhe serbe” nga Kosova, që krijoi “*Serbinë hungareze*” në Vojvodinë, që pastaj “u mbush me arnautë nga Shqipëria veriore”,<sup>937</sup> por përkundrazi e demantojnë atë për vetë faktin se edhe ajo popullatë e vogël që u largua me peshkopin Arsenie Çernojeviq të shumtën ishte nga radhët e shqiptarëve ortodoksë dhe katolikë, ndërsa etnia serbe, bashkë me atë kroate, në atë pjesë, ishte nga mesjeta, bashkë me strukturat e saj autonome “zhupanitë”, që i kishte toleruar

<sup>936</sup> Shih Castellan, Georges: “*Histori e Ballkanit*”, Tiranë 1991, faqe 255.

<sup>937</sup> Shih: J. Cvijić: “*Osnove za geografiju i geologiju Makedonije i Stare Srbije*”, 1906; Василевич, J.X.: „*Јужна Стара Србија*“, I,f.483; Djordjeviq Vladan: “*Die Albanensen und die Grossmächte*“, Leipzig, 1913.

pushteti i Bizantit në mënyrë që në pjesët perëndimore të Ilirikut të sigurohej mbrojtje nga sulmet barbare që vinin nga Veriu.<sup>938</sup>

Me ndonjë përjashtim të vogël, bërthama e strukturave etnike sllave (Kroatëve dhe Serbëve) në këto hapësira, duke përfshirë Kroacinë, Bosnjën dhe Hercegovinën si dhe pjesën e Vojvodinës përreth lumenjve Danub dhe Sava, vazhdoi të mbetet e tillë edhe gjatë pushtimeve osmane. Madje, despotati i Brankoviçëve (nga shumë burime i lidhur me origjinën tribale), jo rastësisht “kështjellën” e kishte në Smederevë. Atje do të ruajë praninë e vet edhe për shumë kohë prej nga do të vazhdojë të dërgojë “mesazhe” shpirtërore në pjesën osmane, ndërkohë që Pashallëku i Beogradit, kishte një pakicë serbe, kryesisht popullatë fshatare, që si e tillë do të mbetet deri te kryengritja e parë serbe e vitit 1804.<sup>939</sup>

Si pakicë e shkapërderdhur, popullata serbe shfaqet edhe në fillim të shekullit XIX në disa qendra urbane (Valeva, Uzhice) ndërsa edhe vetë pasqyra popullore e Shumadisë në atë kohë del “shumë e rralluar”, gjë që do të plotësohet pas Krizës Lindore me serbë nga Bosnja dhe Vojvodina”.<sup>940</sup>

Kjo popullatë, pakicë, kryesisht fshatare, në pjesën e Pashallëkut të Beogradit, do të vazhdojë të ushqehet shpirtërisht me ide perëndimore, për aq sa ishte e mundur, nga “Serbia hungareze”, ndërkohë që kisha ortodokse vendore, si kundërpërgjigje “kurthit katoliko-hungarez” të tërheqjes në uniatizëm, kishte vazhduar përpjekjet për të përforcuar lidhjet e tyre me ortodoksinë drejt Ruisë, ku edhe i varte shpresat për mbrojtje dhe përfshirje në orbitrin e saj shoqëror dhe politik, siç do të ndodhë në të vërtetë.

Por, përpjekjeve të lidhjeve me Rusinë, pak nga pak, do t’u bashkohen edhe disa qarqe të Serbëve të Hungarisë, të cilat tashmë kishin filluar të përfshiheshin në propagandën ruse, e cila, pasi që nga Paqja e Karlovit kishte fituar të drejtën për

---

<sup>938</sup> Rreth shtrirjes së Sllavëve në pjesën veriore të Ilirikut (Vojvodinë) dhe strukturat e tyre autonome (zhupanitë) gjatë mesjetës shih: Constantinus Porphyrogenitus: “*Corpus Scriptorum Historiae Byzantinae*”, Bonnae MDCCXI, faqe 141-148; Jiriček, Konstandin “*Historia e Serbëve*”, Tiranë 2002; “*Vizantijski izvori za istoriju naroda Jugoslavije*”, tom I-IV, Posebna izdanja Vizantološkog Instituta, 3,7,10, 12, Beograd 1955-1971; Čirković, S: “*Srbi u srednjem veku*”, Beograd 1995; *Istorija srpskog naroda*, Beograd 1994; Novaković, Relja: „*Gde se nalazi Srbija od VII do XII veka*“, Beograd, 1906.

<sup>939</sup> Gjerësisht rreth popullatës në Pashallëkun e Beogradit shih Vukanović, Tatomir: “*Naselja u Srbiji u doba prvog srpskog ustanka 1804-1815*“, Vranje 1975.

<sup>940</sup> Rreth plotësimin të popullatës së Principatës serbe të shpallur në vitin 1830 dhe dyfishimit të saj me popullatë të “përthithur” nga Bosnja dhe Kroacia shih: Jagodić, Miloš: “*Naseljevanje Kneževine Srbije 1861-1880*“, Beograd 2004. Jagodić sjell të dhëna se Serbia sapo u shpall principatë kishte rreth 270 mijë banorë. Brenda tri vitesh popullatën do ta dyfishojë në 570 mijë banorë. Tredet e shtimit të popullatës do të zgjasin edhe më tutje, edhe përkundër faktit se mbas luftërave ruso-osmane të vitit 1878 dhe atyre serbo-osmane të vitit 1877/78, nga krahina e Nishit e deri në Prokupje e Kurshumli do të dëbohen mbi 100 mijë banorë myslimanë, të shumtën shqiptarë! (“*Naseljevanje Kneževine Srbije 1861-1880*”, faqe 44, 47, 95, 116 dhe 162).

përkujdesje shpirtërore ndaj popullatës ortodokse të pjesës europiane të Perandorisë Osmane (Ballkanit) ndikimin e ardhshëm e shihte në Pashallëkun e Beogradit dhe Shumadi. Klerikë nga manastiret e Frushka Gorës shkonin në pelegrinazhe në Zagorac ose Peçerskaja Laura dhe nga vendi i carit sillnin imazhin e Tokës së premtuar. Kësaj vale iu bashkuan edhe njerëz të fesë që bënë studimet e tyre në Rusi. I tillë ishte historiani i ardhshëm Jovan Rajiç (1726-1801), i njohur për frymën proruse, e cila kaloi në një shpresë popullore kur Vjena iu bashkua Rosisë në luftën e saj të re kundër Perandorisë Osmane (1788) prej nga lindi edhe ideja për një “*Serbi Mesjetare*”.<sup>941</sup>

Çështja e “Serbisë Mesjetare” doli në pah kur ajo u shkëput nga ideja gjithëpërfshirëse e Ilirikut, ku mungesa e një orientimi se ku duhej të vendosej ajo Serbi (herë në Bosnje, herë në Posavinë, e herë-herë në Shumadi gjithnjë me përfytyrimin e një pashallëku siç ishte ai i Beogradit në afërsi të Hungarisë), së cilës gjithsesi i mungonte një etni kompakte serbe, sidomos në Pashallëkun e Beogradi, ku ata ishin pakicë, për t’u zhdëmtua me “konceptin fetar”. I nisur nga parimi se atdheu është feja, Pavlo Jelinac në vitin 1765 botoi një “*Hyrje të shkurtër në zhvillimin historik të popullit slloveno-serb*”.<sup>942</sup>

Ideja laike e Jelinacit për “Ilirikun” si një atdhe serb në përputhje me fenë, në parim do të pranohet nga Dositej Obradoviç.<sup>943</sup> Obrenoviçi Serbinë e ardhshme, nuk e shihte as në Graçanicë e as në Pejë, siç kishin filluar të trumbetonin disa qarqe kishtarë rusofile, veçse ngjit me Vojvodinën, pra në pjesën veriore, përreth Danubit dhe Savës, prej nga ajo do të mbante lidhjet e natyrshme me “amzën shpirtërore” në Vojvodinë dhe Banat, amëz kjo që shtrihej nga Segedi, Aradi, Temishvari e deri në Vërshac. Andaj, është fare e natyrshme që edhe kryengritja e vitit 1804, e cila filloi si revoltë kundër zullumit të jeniçerëve dhe dainjve të përqendruar në Pashllëkun e Beogradit, dhe gjithë ai zhvillim që do të çojë te dështimi

<sup>941</sup> Po aty.

<sup>942</sup> Rreth veprës së P. Jelinac dhe konceptit të tij rreth “Serbisë shpirtërore”, ku ai u kthehet manastireve mesjetare në Kosovë, shih Haumant, E: “*La Formation de la Yugoslavie*”, Paris 1930, faqe 165-166.

<sup>943</sup> Dositej Obradoviç (1744-1811) lindi në Çakovo, në Banat, në një familje zejtaresh. U bë murg në manastirin e Hopovos, prej nga u largua më 1740 në Zagreb dhe pastaj në malin Athos, ku u zhgënjye dhe u largua për në Halle dhe Lajpzig. Nga vitit 1789 deri më 1802 qendroi në Vjenë prej nga propagonte te serbët për t’iu bashkuar kryengritjes së Karagjorgjit. Asaj iu bashkua më 1806, si mësues i fëmijëve të Karagjorgjit, me ç’rast do t’i jepet edhe titulli i ministrit të parë të arsimit. Vdiq në Beograd më 1811. Vepra e tij kryesore “*Život i priklučenja*” nxjerr në pah idenë se Sllavët e Ballkanit duhet të bashkohen në një familje të vetme (shtet) në Dalmaci, Bosnje, Serbi dhe Slloveni. Shtetin e bashkuar sllav ai e shihte në veri dhe perëndim (në jug të Danubit dhe Savës deri në Krushevc) dhe assesi në Kosovë dhe Maqedoni, siç do të shpallet më vonë në projektet nacionaliste dhe hegjemoniste të Beogradit. Nga pikëpamja kulturore, ka merita të mëdha, që bashkë me V.Karaxhiqin e krijoi gjuhën letrare serbe, duke e shkëputur nga sllavishtja e vjetër, që përdorej nëpër kisha.

i saj dhe rindezja e së njëjtës në vitin 1815, nuk u projektua e as u lidh me asgjë me Kosovën dhe as me “djepin mesjetar shpirtëror serb”, siç do të thuhej më vonë, por e gjitha ruajti konceptin që Serbia e ardhshme të frymëzohet dhe të ndërtohet në Pashallëkun e Beogradit e deri në Shumadi, gjithnjë e ndërlidhur me bërthamën intelektuale dhe shpirtërore që e kishte në Hungari (Vojvodinë, Srem dhe Banat).

Këtë Serbi, ngjitur me Hungarinë, e donte edhe frymëzuesja e saj e mirëfilltë Austro-Hungaria, e cila kishte investuar aq shumë në këtë ide në planin kulturor, shoqëror e së fundi edhe atë politik. Dhe, këtë Serbi, e donte edhe Rusia, ndonëse ideja e shtetit të ardhshëm serb në Vjenë projektohej të ishte një vasale e saj, piemont i Sllavëve të Ballkanit, i lidhur me Perëndimin, ndërsa Rusia e kërkonte një vasale me anën e të cilës do të shtrinte ndikimin e saj në Europën Juglindore, me ç’rast Sllavët do të lidheshin me idenë e ortodoksisë për qëllimet hegjemoniste ruse.

I mendësisë se shoqëria serbe, pa marrë parasysh statusin e saj të përkohshëm nën Perandorisë Osmane (autonomi ose knjazhevinë), nga pikëpamja ekonomike dhe politike do të duhej të ishte i lidhur me Vjenën, por që kisha e saj të ruante përkatësinë ortodokse, ishte edhe prijësi i saj i parë, Aleksandër Karagjorgjeviq.<sup>944</sup>

Karagjorgji, i cili pas paqes austro-turke u kthye në Pallankë dhe në milicinë vendore të organizuar nga Haxhi Mustafa mori gradën e *bylykbashit*, ndjehej mirë në krye të milicisë vendore dhe as që jepte shenja të ndonjë rebelimi, që do ta prodhojnë rrethanat e mëvonshme. Por, do të jenë jeniçerët, që pasi u rebeluan kundër sulltan Selimit III, u kthyen në Pashallëkun e Beogradit dhe filluan zullumet e tyre të njohura, do ta detyrojnë Karagjorgjin që në cilësinë e *bylyk-bashit* e pak më vonë edhe të “prijësit” (vodzha) të luftonte kundër tyre dhe *dahive* përkrah pashait të Beogradit, Haxhi Mustafa, i cili u vra prej tyre, me ç’rast ai doemos duhet të vazhdonte luftën kundër jeniçerëve të harbuar, duke e bartur atë në pjesët

---

<sup>944</sup> Për Gjorgje Petroviqin, i quajtur Karagjorgj, Gjergji i Zi, dihen pak gjëra. Biografia e tij ngjanë më shumë në një gojëdhënë, prej nga mund të kuptohet se ka lindur në Shumadi, në Vishevac, pranë Raçës, ku thuhet se është pagëzuar në një datë që lëviz nga 1762 deri më 1769. Në vitin 1787 familja e tij u largua nga Shumadija dhe u vendos në Vojvodinë, ku u vu në shërbim të manastirit të Krusedolit. Kur Austria i shpalli luftë Perandorisë osmane, Karagjorgji 20 vjeçar u angazhua në forcat e *Freikorps-it* serb dhe luftoi në Serbinë Perëndimore, ku mësoi artin ushtarak dhe arriti gradën e nënoficerit. Pas paqes së Shistovës, u kthye në Topollo si tregtar derrash. Kur Haxhi Mustafa organizoi milicinë serbe, Karagjorgji u bë *buljuk-bash* (shef i një qindësheje) i krahinës dhe u familjarizua me taktikën osmane. Kur u kthyen jeniçerët ai doli në mal kundër tyre, me çka kjo mori përmasat e një kryengritje të përgjithshme, ku ai u zgjodh edhe komandant i tyre. Disa historianë serbë origjinin e Karagjorgjeviqit e lidhin me një familje shqiptare nga Kelmendi, e shpërngulur në Shumadi e pastaj në Vojvodinë pas humbjes së luftës austro-turke, me ç’rast një pjesë e madhe e fisit të Kelmendit u detyrua bashkë me ushtrinë austriake, të marrë ikën për në veri. Më gjerësisht rreth origjinës shqiptare të Karagjorgjeviqit shih: Milorad Bošnjak-Slobodan Jakovljević: „*Karađorđevići – skrivena istorija*“, Gornji Milanovac, 2007).

rurale, ku kishte mundësi të mira për luftë kaçake, që tashmë kishte filluar të përdorej nga *hajdutët* (njësi vullnetarësh popullorë që po ashtu luftonin kundër jeniçerëve, por që ishin tepër të padisiplinuar dhe të dëmshëm).

Me përvojën ushtarake austro-hungareze, Karagjorgji ia doli që shumë njësi jeniçerësh, të cilët po ashtu ishin jashtë ndonjë mbikëqyrjeje dhe bënë zullume në popull, t'i zbraps dhe së fundit t'i detyrojë që të mbyllen në kalanë e Beogradit. Kështu, një luftë kundër jeniçerëve të rebeluar në mbrojtje të autoritetit të sulltanit, Karagjorgjin e ktheu në një prijës të kryengritjes popullore, në të cilën, pak nga pak nisën t'i fusin gishtat Austro-Hungarezët edhe Rusët, secili për hesape të veta.

Meqë në atë pështjellim luftime ishin *dahitë* (krerët e jeniçerëve, që drejtonin pashallëkun), që po ashtu kishin vendosur një lloj terrori të dyfishtë (ndaj spahinjve dhe knezëve të krishterë që bashkërisht luftonin zullumin), Karagjorgji u desh të luftonte edhe kundër tyre, luftë kjo që mori përmasa në gjithë vendin, prej nga *disaknezë* (*prijës*) vendorë tashmë kishin filluar të hynin në lidhje me përfaqësues të Portës rreth një marrëveshjeje që parashikonte së pari eliminimin e *dahive*, dhe pastaj shkonte edhe deri te kërkesa për njohjen e një autonomie në kuadër të Perandorisë, autonomi që duhej të përfshinte liritë fetare dhe tregtare dhe emërimin e një "knezi suprem" (udhëheqës, drejtues) të serbëve.<sup>945</sup>

Kërkesat serbe, të cilat nga Zemuni (Semlin) iu parashtruan përfaqësuesit osman më 10 maj 1804, iu dërguan sulltanit, por në vend se t'u jepte përgjigje politike, ai vendosi që gjithë revoltën e popullatës serbe ta fashiste duke ndëshkuar *dahitë*, të cilët, në atë pjesë, jo vetëm që po ia rrezikonin reformat, por njëherësh po përgatisnin terrenin për një rebelim të përgjithshëm kundër tij, gjë që pas pak kjo edhe do të ndodhë. Duke e kuptuar rrezikun, Selimi III ngarkoi vezirin e Bosnjës, Beqir Pashën të ndihmonte Serbët të dëbonin *dahitë* e rrezikshëm.<sup>946</sup>

Fushata e pashait të Bosnjës kundër *dahivetë* Beogradit filloi në korrik të po atij viti, së cilës iu bashkua Karagjorgji me rreth dy mijë kalorës serbë. Veprimet e përbashkëta të njësive osmane nga Bosnja dhe vullnetarëve të Karagjorgjit pa ndonjë mund të madh thyen *dahitë*, të cilët u tërhoqën në drejtim të Vidinit, për të kërkuar mbështetje tel Pasvanoglu, i njohur për rebelimet kundër sulltanit.

Fitorja ndaj *dahive* në bashkëveprim me Osmanët nuk ia siguroi Karagjorgjit autonominë siç e kishte paraparë. Vjena, e cila ishte ndërmjetëse në këto bisedime, ndërroi mendjen pas veprimeve të Napolonit, të cilat po ndryshonin raportet e

<sup>945</sup> Shih Castellan, Georges: "*Histori e Ballkanit*", Tiranë 1991, faqe 265.

<sup>946</sup> Më gjerësisht shih: Petrovich, Boro Michael: "*A History of Modern Serbia: 1804-1918*", New York, 1976, vol. I. Faqe 28-29.

forcave në Europë dhe më gjerë. Po ashtu, edhe Rusia, që ishte e përfshirë në luftë kundër Napolonit nuk ishte e interesuar për një konfrontim të ri me Portën shkaku i Serbëve, por vazhdoi që të kërkonte përhapjen e një kryengritje të të gjithë të krishterëve në Ballkan, e cila pak nga pak zuri të përfshinte Hercegovinën, pastaj me çetat e *klefëve* të përhapej edhe në Epir dhe Thesali, frymë kjo që nga *hospodorët fanariotë* do të bartet edhe në Vllahi dhe Moldavi.<sup>947</sup>

Duke parë shpërthimin që po i përgatitej, Porta, pasi që emëroi guvernator të Beogradit Hafiz Pashën e Nishit, e nisi atje në krye të një ushtrie, e cila duhej të qëronte hesapet me kryengritësit vendor. Ndeshja e parë midis trupave të rregullta osmane dhe kryengritësve vendor, të quajtur romej, u bë në gusht të vitit 1805 në Ivankovo, pranë Çuprisë. Kryengritësit detyruan ushtrinë osmane të tërhiqej. Kjo trimëroi Karagjorgjin që t'i drejtohej Beogradit, me ç'rast në nëntor të vitit 1806 e pushtoi, i bindur se kështu kishte krijuar parakushtin që ta shpallte një vilajet autonom. Por, fati i vilajetit autonom varej nga zhvillimi i luftës midis Perandorisë Osmane dhe Ruisë, e cila shpërtheu në vjeshtën e atij viti, me ç'rast Karagjorgji, i cili shpresonte në fitoren e Ruisë, shkeli një marrëveshje që ditë më parë kishte arritur me përfaqësuesit e Sulltan Selimit rreth një autonomie vendore, duke refuzuar pagesën e haraçit si dhe për të dërguar trupa kundër rusëve me arsyetimin se “Serbia e konsideron veten shtet të pavarur”.<sup>948</sup>

Në këto rrethana, kemi shfaqjen e një misioni rus në pashallëkun e Beogradit, i drejtuar nga koloneli F.O. Pauluci, me të cilin u nënshkrua një konventë, sipas të cilës Serbia kthehej në një protektorat rus në të gjitha drejtimet. Petërburgu dërgoi në Beograd edhe një përfaqësues të përhershëm, Konstandin Rodofikinin, i cili shfaqej si mbikëqyrës i protektoratit, duke nxitur intriga me anën e të cilave Karagjorgji i ngushtoj hapësira.

Për Karagjorgjin dhe projektin e vilajetit autonom, paqja e Ruisë me Napoleonin, në Tilsit më 7 korrik si dhe armëpushimi i Ruisë me Portën në Slllobozias, më 24 gusht, shënuan një kthim prapa, ngaqë në asnjërën nga këto marrëveshje nuk u bë fjalë për “shtetin autonom”, kështu që në planin ndërkombëtar ata vazhdonin të ishin të varur nga sulltani.<sup>949</sup>

Kjo bëri që Karagjorgji të ndjehej i tradhtuar nga Rusët. Për t'u forcuar, së pari shpalli veten “udhëheqës suprem brez pas brezi”, ndërkohë që në lojërat midis Vjenës dhe Petërburgut, iu kthye kartës së Vjenës, me ç'rast në një takim me

---

<sup>947</sup> Shih Castellan, Georges: “*Histori e Ballkanit*”, Tiranë 1991, faqe 256.

<sup>948</sup> Po aty, faqe 267.

<sup>949</sup> Po aty.



mareshalin von Simbschen, komandant i kufirit, shprehu dëshirën që Serbia të bëhej protektorat i Habsburgëve, i varur nga Vjena dhe jo nga Mbretëria e Hungarisë, kurse Beogradi do të kthehej në një qendër të fortifikuar austriake.<sup>950</sup>

Pretendimet që të kthehej kah Vjena dhe një nismë tjetër e ngjashme në vitin 1908 kah Napoloni, Serbisë i kushtuan, ngaqë Rusia, pasi shënoi suksese në disa fronte dhe ushtria e saj në verën e vitit 1810 kaloi Danubin, disa garnizone të saj u vendosën në Beograd. Pas prishjes me Napolonin dhe luftës me të, Aleksandri I sërish iu kthye bisedimeve me Osmanët, të cilat, në vitin 1812, përfunduan me Traktatin e Bukureshtit, i cili parashihte një autonomi serbe si dhe rikthimin e garnizoneve osmane në Serbi sipas gjendjes së vitit 1804. Kjo marrëveshje u përcoll me largimin e garnizoneve ruse nga Serbia, të cilat duhej t'ua lëshonin vendin atyre osmane. Në një asamble në Kragujevc, në janar të vitit 1813, Serbët i hodhën poshtë vendimet e Traktatit të Bukureshtit, gjë që kjo sulltanit i shërbeu si shkas për të nisur një fushatë ushtarake kundër tyre, të kryesuar nga Kurshid pasha. Serbët kërkuan ndihmë na Rusia dhe Austria, por Rusia e zënë në luftë me Napolonin premtoi vetëm strehim të refugjatëve dhe asgjë më shumë, ndërsa Vjena premtoi se mund të merrte rolin e ndërmjetësuesit në bisedime me Kurshid pashën. Të mbetur vetëm, Serbët kapitulluan para ushtrisë osmane, e cila më 3 tetor 1813 hyri në Beogradin e shkretuar, ndërsa Karagjorgji me bashkëluftëtarët ia mbathën përtej Savës, në Hungari.<sup>951</sup>

Disfata e Karagjorgjit, amnistia e shpallur nga e cila përfituan të gjithë midis tyre edhe krerët e kryengritjes si Milosh Obrenoviqi i emëruar *knez*(prijës) i krahinës së Rudnikut në Shumadi si dhe kthimi i pashallëkut të Beogradit bashkë me spahinjte, nuk ia ktheu vendit qetësinë e pritur. Sepse, ishin dy faktorë, që këtë nuk e lejonin: të ikurit në Hungari, që nisën të përdorën për interesat e Austro-Hungarezëve për përhapjen e kryengritjeve në pashallëkun e rikthyer të Beogradit, që do t'i shkonin për kuti Perandorisë, dhe po ashtu ishte edhe Rusia, e cila pas fitores ndaj Napolonit në gushtin e vitit 1914, serish iu kthye planeve për shtrirjen në Ballkan, me instrumentalizimin e Sllavëve të Jugut dhe besimtarëve ortodoksë, për ç'gjë tashmë, në cilësinë e “mbrojtësit shpirtëror”, kishte edhe mandatin nga Fuqitë e Mëdha.

Edhe me këtë rast referenca kryesore e kryengritjeve mbeteshin *knezët* (prijësit vendorë), të cilët mund të vepronin pa ndonjë mund të madh në rrethanat kur

---

<sup>950</sup> Po aty, faqe 268.

<sup>951</sup> Shih Glenny, Misha: “*Histori e Ballkanit 1804-1999*”, Tiranë 2000, faqe 18; Jovanović, Slobodan “*Iz istorije i književnosti*”, Beograd, 1931, vol.I, faqe 53,70.

ata tashmë ishin zot të pushtetit vendor. Ishte Haxhi Prodani i Çaçakut, i cili ngrit krahinën e tij në kryengritje, që u kthye në shkas të një konflikti tjetër të serbo-osman, që çoi deri te autonomia e Serbisë, e cila do të arrihet në vitin 1830, me ç'rast Millosh Obrenoviçi dinak do të njihet princ-trashëgimtar i Serbisë autonome.<sup>952</sup>

Sigurimi i statutit të princit-trashëgimtar, për Obrenoviçin ishte më tepër një luftë diplomatike, të cilën ai nga vitit 1817, kur ia mori tradhtisht kokën Karagjorgjit, i cili ishte dërguar në Serbi si agjent i “*Filiki Hetarias*” (Shoqëria e Miqve), organizatë revolucionare greke nga Odesa, që luftonte për destabilizimin e pjesës europiane të Perandorisë Osmane, si përgatitje për një kryengritje të armatosur dhe ia dorëzoi sulltanit, e zhvilloi me sukses duke u bërë ballë sfidave të shumta të luftërave nëpër të cilat kalonin Perandoria Osmane dhe Rusia, por edhe të Fuqitë e Mëdha (Napoloni, Anglezëve për dominime të reja). Obrenoviçi gjatë gjithë kohës vepronte me shumë maturi, i bindur se ishte sjellja diplomatike që i siguronte më shumë se luftërat për qëllime të huaja, të cilat në ato rrethana sikur ishin të pashmangshme, por që shumë prej tyre ia doli t’i bishtnonte, duke u përqendruar që detyrimet ndaj tyre t’i përmbush vetëm si furnizues ushqimesh (i mishit të derrave) njëherësh ndaj ushtrive më të mëdha të kohës, asaj austriake dhe ruse. Që të fitonte sa më shumë e të jepte sa më pak, ai përdorte edhe bakshishet e shumta, siç ishin ato që ai pagoi që në Paqen e Adrianopojës (shtator 1829) ku përfshihej edhe dekreti (*khatt-i sherifi*) për trashëgim të titullit.

Obrenoviçi u tregua edhe më dinak me rastin e përhapjes së kryengritjes në Bosnje, të cilën e ndezi në të gjitha anët, ndërkohë që mobilizimin gjoja për t’i ndihmuar sulltanit për ta shuar, kur sulltani nga rrethanat e ndodhjes në luftë me Rusinë u tërhoq prej saj, e përdori për t’u zgjeruar edhe në gjashtë nahije të sanxhaqeve të Novi Pazarit, Kurshvecit dhe Vidinit, pranimin e të cilave ai po ashtu e siguroi me bakshishe sulltanit. Me atë rast, me *khatt-i sherifin* e majit të vitit 1833 Serbisë autonome ia zgjeroi kufijtë duke përfutuar kështu nga 24 mijë në 37 mijë kilometra katrore, territor ky që mbeti i pandryshuar deri më 1878.<sup>953</sup>

Shfaqja e Serbisë autonome në vitin 1833, hapi kutinë e Pandorës në pjesën europiane të Perandorisë Osmane, në përputhje me skenarët që asaj i ishin paraparrë në Rusi, po edhe në disa qendra të tjera europiane (fillimisht në Vjenë e pastaj në Londër e Paris). Ndonëse, zhvillimet në të dukeshin paksa “më të thjeshta”, për nga përfshirja e faktorëve të jashtëm në të, u dha shkas zhvillimeve të tjera të

---

<sup>952</sup> Po aty.

<sup>953</sup> Po aty.

ngjashme për faktin se Serbia autonome, frymëzonte edhe pjesën tjetër të serbëve, të përhapur në Bosnje e Hercegovinë dhe në jug (drejt Maqedonisë dhe Kosovës ku kishte një pakicë), që si do të shihet për ta do të projektohen planet hegjemoniste për krijimin e një “Serbie të Madhe”, që do të prodhojnë atë që më vonë do të shfaqet si Krizë Lindore dhe vuri në lëvizje zhvillimet me anën e të cilave do të shkohet edhe deri te pika kur do të shembet Perandoria Osmane.

Në këto zhvillime dinamike që do të plotësojnë mozaikun e ngjarjeve që do të krijojnë rrethana për shembjen e Perandorisë Osmane, gjithsesi se Pavarësia e Greqisë dhe gjithë ato që ishin pjesë e këtij procesi (kryengritjet greke 1821-1825 dhe ndërhyrja europiane 1826-1833), paraqesin një nga ngjarjet më të mëdha të Europës së Restaurimit, nga shkakut se si çështjes ajo lidhej me kompleksitetin e madh të botës helenike, që depërtonte thellë në qytetërimin europian,<sup>954</sup> por lidhej edhe me ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të fuqive të mëdha europiane në zgjidhjen e saj që iu imponua Perandorisë Osmane në rrethanat kur ajo ushtarakisht i kishte dhënë disfatë të pariparueshme asaj.

Kjo çështje, që apriori mund të ishte e natyrës kulturore, megjithatë u rikthye në çështje politike të intensitetit të lartë, ku puqeshin por edhe konfrontoheshin interesat e fuqive të mëdha: në njërin anë të Rusisë, e cila me ombrellën e “përkujdesjes për besimtarët ortodoksë” në Perandorinë Osmane të fituar në Traktatin e Kyçyk Kajnarxhisë më 1774, nënkuptonte jo vetëm Sllavët e Jugut por edhe të tjerët me çka ajo me këtë formulë krijonte mundësi për përfshirje edhe të Greqëve dhe të Vllahëve në hesapet e veta, dhe në tjetrën anë të Britanisë së Madhe dhe të Francës, të cilat krizën e Perandorisë Osmane dhe fundin e pashmangshëm të saj në pjesën europiane, zunë ta shohin si një mundësi e madhe që hapësira e Greqisë të kthehet në një bazë të tyre mesdhetare që t’u shërbente për depërtime të tjera nëpër rrugë ujore dhe tokësore kah Lindja e Mesme dhe Largët e deri në Indi. Aty ishte edhe politika e tyre afrikane, ku Greqia po ashtu luante një rol të rëndësishëm.

Në këtë gërshetim interesash, natyrisht se Rusia mbante kartat më të forta, sepse faktori ortodoksi si dhe kisha lindore nën drejtimin e fanariotëve, kishte peshë të veçantë për faktin se ajo prej kohësh anti-latinizmin e saj tradicional e kishte kthyer në anti-oksidentalizëm, gjë që do të ndikojë që ndonëse me disa hezitime që kishin të bënin me statusin e privilegjuar nga Perandoria Osmane.<sup>955</sup> Me këtë

---

<sup>954</sup>Castellan, Georges: “*Histori e Ballkanit*”, Tiranë 1991, faqe 276.

<sup>955</sup> Në Perandorinë Osmane, që nga fillimi Kisha Ortodokse kishte pranuar nënshtrimin sulltanit ku patriarku kishte vendin e vet hierarkik të pashait me tri *tug* si *bashi* i Rum Miletit, ndërsa kisha kishte pasuri të mëdha

frymë frymëzoheshin dhe të ndërlidheshin madje edhe lëvizjet kombëtare, kryengritjet si dhe programet e ndryshme për qëllime politike, siç ishte vepruar te Serbët me rastin e kryengritjeve të tyre dhe siç do të veprohet edhe në rastet tjera në vijim.

Te ajo që merrej si Greqi, megjithatë shfaqeshin edhe disa faktorë të tjerë, ndër të cilët ai i natyrës etnolinguistike, që atë që quhej “popull grek”, formula e besimit të përbashkët ortodoks nuk mund t’ia krijonte unitetin kombëtar në përputhje me doktrinën e helenizimit “kush është grek është ortodoks, dhe kush është ortodoks është grek”. Sepse, me këtë nuk pajtoheshin as Vllahet, as Sllavo-Maqedonasit, e as Shqiptarët, të cilët ishin faktor dominues etnik në atë që gjeografikisht përkufizohej Greqi në ato rrethana, çështje kjo që si do të shihet, do të paraqesë shkakun për mospajtime, ngatërresa dhe madje lufta të ardhshme midis popujve të kësaj hapësire që për shekuj kishin ndarë fatin e përbashkët nën pushtimin osman, edhe pse, fillimisht disa nga këta popuj, në parim do ta përkrahin kryengritjen greke si dhe helenizmin, si një kornizë e përgjithshme ku mund të gjenin përgjigje edhe çështjet e veçanta, pra ato të çlirimit kombëtar të popujve veç e veç.

Laramanisë gjuhësore (identiteti gjuhësor), të cilit nuk kishte qenë në gjendje t’ia humb ngjyrimin as fuqia e kishës me ushtrimin e meshës në gjuhën greke si dhe përcaktimin e saj të njohur helenizues, i shtohet edhe ai i mozaikut shoqëror me ndryshime të mëdha nga pjesa në pjesë dhe dallime të papërballeshme sociale dhe etnike madje, siç ishin ato midis popullsisë së pjesës kontinentale (Traki, Thesali e banuar me Vllahë dhe Sllavo-maqedonas), asaj të jugut – (Peleponezit me qeverisje autonome), Ishujve, (me Arvanitasit e shumtë)<sup>956</sup> dhe të Epirit, një popullate autoktone e mbizotëruar nga Shqiptarët myslimanë me strukturat e tyre të njohura fisnore, që kishin ruajtur qeverisjen autonome edhe gjatë Perandorisë Osmane.<sup>957</sup>

Kjo larushi nxirrte në pah vështirësitë me të cilat do të përballej “uniteti i brendshëm”, po qe se do të mbështetej vetëm mbi faktorin fetar siç kërkonin Rusët, gjë që kjo do të jetë arsyeja që proklamatat e para për thirrje në kryengritje

---

të integruara në *vakëfe*. Kështu, shpjegohen ato “këshillat princore” të patrikut Greguar më 1798, i cili u thoshte besimtarëve të tij se “sulltani ishte, pas Zotit, sovran i të krishterëve, ruajtës i pasurive dhe i jetës së tyre” dhe se “ata që predikojnë ëndrra lirie vepronin në kundërshtim me Shkrimet e Shenjta dhe ishin të shtyrë nga Djalli”. (Shih: Castellán, G. “*Histori e Ballkanit*”, Tiranë 1991, faqe 279).

<sup>956</sup> Shih Glenny, Misha: “*Histori e Ballkanit 1804-1999*”, Tiranë, faqe 25 ( “Anëmbanë Rumelisë, Peleponezit dhe ishujve kishte bashkësi të mëdha shqiptarësh – pjesa më madhe të krishterë ortodoksë, kurse në qendrën epirote të pashait rebel, Ali Pashait, mbizotëronin Shqiptarët myslimanë. Shumë shqiptarë kaluan nëpër një proces helenizimi, që u përshpejtua me pjesëmarrjen në Luftën për Pavarësi. Kunduriotët, për shembull, familja më e fuqishme e lundrimit detar në ishullin Hidra, që udhëhoqi një krah të rëndësishëm gjatë luftës, ishin me prejardhje shqiptare”)

<sup>957</sup> Glenny, Misha, vepra e cituar, po aty, faqe 25.

të manifestojnë shumësinë e etnike bashkë me idenë se Greqia (për herë të parë si nocion shtetëror), mund të jetë pjesë e një federate të brendshme popujsh të krishterë të Ballkanit.

Por, Rusia dhe disa qendra europiane, që kishin fokusuar interesat e tyre te “populli grek” si dhe ngritja e saj në një çështje europiane, në mënyrë që prej andej ta nxjerrin më lehtë nga zgjedha osmane, faktorin fetar dhe përkatësinë e krishterë-ortodokse, do ta ndërlikonin edhe me idetë e reja europiane që dolën në pah pas Revolucionit Francez, meqë kështu mund të krijohej mundësia për t’i hequr nga rruga vështirësitë që mund të shfaqnin realitetet e ndërlikuara etnike dhe ato gjuhësore, të cilat mund të pengonin formulën politike “të një shteti të përbashkët”, i cili nuk mund të pranohej as nga bullgarët, as nga vllahet, dhe veçmas nga Shqiptarët, çështjen e të cilëve e rrezikonte më së shumti, kur dihej se një pjesë e madhe e popullatës së jugut ruante besimin e krishterë të rritit ortodoks dhe përcaktimi për modelin e shtetit të krishterë, jo vetëm që përjashtonte pjesëtarët e besimin mysliman, të shumtë në këtë hapësirë, por njëherësh ata i vente në pozita konfrontuese me të dhe madje i kthente në mbrojtës të Perandorisë Osmane edhe në rrethanat kur asaj mund t’i kalonte koha.

Kjo do të jetë edhe arsyeja që ideja për kryengritje të përgjithshme, nën moton për çlirim nga zgjedha osmane, Grekëve t’u vijë “nga diaspora”, ide kjo që megjithatë joshëse e bëri Revolucionin Francez dhe veçmas shfaqja e Napolonit dhe paraqitja e trupave të tij në brigjet e Adriatikut (pushtimi i Ishujve Jonianë prej vitit 1807 deri në vitin 1814), me ç’rast u krijuan rrethanat për shkëputjen e tyre nga pushtimet e huaja. Kështu, apostuj të mesazhit revolucionar francez, u bënë dy shkrimtarë: Rigas Velestinlis (1757-1798) dhe Adamantios Korias (1748-1833). I pari, Rigas Velestinlis, i lindur në Thesali, por i formuar në mjedisin fanariot të principatave ku ishte bërë sekretar i *gospodarit (prijësit)* të Vllahisë, pas një kohe u vendos në Vjenë (1796) ku edhe u bashkua me ëndrrat e qarqeve helenike për një kryengritje të popujve të krishterë të Ballkanit për të cilën monarkia po ashtu ishte e interesuar edhe me çmimin e koncesioneve të caktuara që t’ia jepte orientimin perëndimor në mënyrë që ta shkëpuste nga ndikimi i madh rus në të cilin ishte përfshirë. Me këtë ide ai u nis për në Greqi, por në Triestë u arrestua nga policia austriake dhe si nënshtetas i sulltanit iu dorëzua pashait të Beogradit, i cili urdhëroi të ekzekutohej më 1798”.<sup>958</sup>

---

<sup>958</sup> Castellán, Georges: “*Histori e Ballkanit*”, Tiranë, 1991, faqe 279.

Edhe i dyti, Adamantios Korais “ishte ithtar i madh i iluminizmit në formën e tij franceze”. Nga ditët e para të ekspeditës së tij në Egjipt, u vu në shërbim të Bonapartit. I bindur se vepra e Napolonit mund të ishte shpëtimtare për një Greqi neohelenike, ai synoi që të rikthente ndërgjegjen e një të kaluarë të lavdishme antike. Për këtë qëllim ai doli me *katharevusën*, një model i gjuhës letrare moderne i sajuara midis greqishtes së vjetër dhe gjuhës popullore.<sup>959</sup>

Kryengritja helene do të frymëzohej më drejtpërdrejt nga një ëndërr panhelenike me ndikim rus, ëndërr kjo që kishte për themel një lëvizje tradicionale fshatare. Pas disfatës së Napolonit, me ç’rast përfundimisht ishte hequr edhe ndikimi i Francës në Greqi dhe Adriatik, Aleksandri i Rusisë, mori përsipër frymëzimin e një kryengritjeje, e cila do të mbështetej mbi klimën e misticizmit politiko-fetar rus. Me këtë rast, cari rus, nisi në Ballkan shumë nga agjentët që kishte mobilizuar në rrethet e refugjatëve grekë, serbë dhe bullgarë të Rusisë Jugore. Paraprakisht, tre tregtarë – Kanthos nga ishulli Patmos dhe dy nga Epiri (Skufas nga Arta dhe Cakallov nga Janina) themeluan në Odesë një “Shoqëri të Miqve” (*FilikiHetaria*).

Kjo shoqatë e fshehtë kryekreje sipas modeleve të masonerisë, ishte në shërbim të politikës ruse, kishte për qëllim që të provokonte një kryengritje të përgjithshme në Ballkan, që pastaj do t’i jepte shkas për ndërhyje ushtrisë cariste.<sup>960</sup> Andaj, nuk ishte e rastit që kryetari i parë i saj ishte një helenofil, Aleksandër Ipsilantisi, oficer nga familja fanariote që shërbente në ushtrinë ruse. Ai planifikoi dhe udhëhoqi kryengritjen e parë pa sukses, në Principatat e Danubit.

“Hetaria” fillimisht shfaqej me një frymë “më të gjerë”, ku duhej të përfshihejshin të gjithë të krishterët ortodoksë dhe jo vetëm helenët në kuptimin etnik. Me këtë thirrje, që si do të shihet do të jetë e njëanshme, ajo bashkoi disa personalitete të shquara në këtë veprimtari fillimisht në Odesë, e më pas edhe në vende të tjera si dhe në Greqi dhe Turqi, duke përfshirë edhe fanariotë të njohur nga Stambolli, të cilët u kthyen në militantë të saj. “Hetaria” u përpoq dhe këtë madje e bëri me sukses që të mblidhte rreth veti si helenët bizantinë, nga jashtë të konvertura në “grekë”, ashtu edhe Shqiptarët dhe Vllahët. Me Ali Pashën e Janinës, kur në vitin 1819 kishte hyrë në luftë të haptë me sulltanin, “Hetaria” arriti një marrëveshje për bashkëveprim.<sup>961</sup>

---

<sup>959</sup> Po aty, faqe 280.

<sup>960</sup> Glenni, Misha, vepra e cituar, faqe 26.

<sup>961</sup> Më gjerësisht rreth bashkëpunimit të Ali Pashës së Janinës me “Heterinë” shih e “*Life of Ali Pascha of Janina*”, London 1823; “*Historia e popullit shqiptar*”, I, Tiranë 2002; Brun, Conrad-Malte: “*Për Shqipërinë*”

Por, lufta e Aliut me Sulltanin dhe shkuarja e saj kah fundi tragjik që do ta marrë pas një viti, kryengritjes greke sikur ia kishte përcaktuar dinamikën e pandalshme, meqë Porta, e cila kishte njohuri për “Hetarinë” dhe qëllimet e saj, kërkonte që përgjigja që po i jepej Ali Pashës së Janinës të merrej si një mësim, në vend se kjo t’i lejohej ta bënte ai.<sup>962</sup> Kjo kishte bërë që veziri i madh, në mars të vitit 1821, pasi që ditë më parë të ishte shuar kryengritja e Ipsilantisit në Principatat e Danubit, kishte thirrur në një takim “mirëkuptimit” peshkopët dhe parinë e Peleponezit. Ndërsa ata që rrinin anash dhe në mënyra të ndryshme kishin futur gishtat në të, jo vetëm që nuk do ta miratojnë takimin e “mirëkuptimit” e parisë me vezirin e madh, por do të bëjnë çmos që luftën kundër Pashasë së Janinës dhe fundin e tij të pashmangshëm ta shfrytëzonin për bartjen e saj në binarët e një kryengritjeje greke kundër Perandorisë osmane, meqë vlerësohej se kryengritja e Ali Pashës asaj mund t’i shërbente si një shtysë e mirë që të kthehej në një çështje greke të përmasave europiane, ku edhe synohej.

Kjo do të bëjë që më 2 prill 1821, ata që nuk kishin pranuar të merrnin pjesë në takimin e “mirëkuptimit” me vezirin e madh (ndër ta ishin hetarisët si peshkopi i Patrës, Germanos dhe krerët e Manit), të cilët kryengritjen e Ipsilantisit e merrnin si fillim i luftës greke për pavarësi, të hedhen në kryengritje. Kjo kryengritje, në të cilën morën pjesë shumë emisarë rusë dhe të huaj, kryesisht ushtarakë tebdil, armët i drejtoi kundër popullatës së besimit mysliman, funksionarëve osmanë, ulemasë dhe tregtarëve, me ç’rast, pas rënies së qytetit Tripoli, u kryen masakra të papara ndaj popullatës së pambrojtur, ku thuhet se u vranë rreth 40 mijë veta, një pjesë e tyre e madhe arvanitas të besimit mysliman.

Kjo sjellje, që ishte paraparë nga jashtë, që shteti i ardhshëm grek të jetë vetëm për të krishterët, pa marrë parasysh se shumë prej tyre ishin të një gjaku dhe etnie me ata që kishin pranuar islamin, do ta tmerrojë edhe historianin filogrek George Finlay, i cili me këtë fjalë përshkroi njëjërën ndër këto masakra:

“Qenia njerëzore rrallë mund të ketë kryer kaq shumë akte mizore mbi një numër të barabartë bashkëqytetarësh të tyre, sa ç’u kryen në këtë rast... Gra e fëmijë iu nënshtruan torturave të vazhdueshme e pastaj u vranë. Dyzet e tetë orë pasi

---

*dhe Shqiptarët*” Tiranë, faqe 171-226; Arvantios: “Historia e Ali Pashë Tepelenës”, (greqisht) Athinë 1895; Castellas, Geoges: “*Histori e Ballkanit*”, Tiranë 1999, faqe 282; Glenny, Misha: “*Histori e Ballkanit 1804-1999*”, Tiranë, faqe 27-28.

<sup>962</sup> “Revolucioni grek, shpërtheu, sepse Osmanët gabimisht vendosën të nënshtronin të vetmin që mund ta kishte parandaluar atë kryengritje – Ali Pashain” ( Shih Denis N. Skitios: “*Ali Pasha’s Last Gamble*”, në “*Hellenism and the Greek War of Liberation (1821-1830)*”: Continuity and Change, ed. Diamandouros, Thessaloniki, 1976, faqe 97.)

kishin marrë qytetin, Helenët apostafat mblodhën rreth dy mijë veta të çdo moshe e gjinie, më së shumti gra e fëmijë, dhe i çuan buzë një humnere në malin më të afërt, ku nuk lanë as dhe një shpirt të gjallë”.<sup>963</sup>

Se masakra ndjek masakrën, kjo u pa nga veprimi i një grupi jeniçerësh, të cilët ditën e pashkëve më 1821 varën te porta e kishës së Fanarit patrikun Gregor V, përkundër asaj se ai kishte dënuar kryengritësit. Hakmarrja ra mbi shumë peshkopë dhe një numër të madh Grekësh të Stambollit dhe të qyteteve të tjera.<sup>964</sup>

Kësaj lufte, e cila në shumë pjesë të Greqisë mori përmasat e një lufte vëllavrasëse, megjithatë iu fshehën përmasat e njëmendta, duke e vendosur në planin fetar si luftë e pushtetit osman kundër popullatës së krishterë helene, që luftonte për liri dhe jo të shqiptarëve të besimit ortodoks (arvanitasve) kundër vëllezërve të tyre të besimit mysliman. Në këto rrethana, kur kryengritja gjithnjë e më shumë po merrte përmasat e një lufte qytetare dhe mund të shkiste fare nga projektet që i ishin paraparë nga jashtë, veçmas nga Rusia, u kërkua që ajo të kanalizohet nëpërmes një legjitimitimi nga brenda me anën e nxjerrjes se një qendre që do të merrte përsipër shpalljen e shtetit grek. Kjo u mundësua në sajë të një marrëveshje që “Hetaria” lidhi me prijësin *kleft*, arvanitasin Th. Kollokotroni. Në dhjetor të vitit 1821, në Epidaur u mblodh një asamble kushtetuese, me ç’rast u hartua edhe një kushtetutë, që ua besonte pushtetin ekzekutiv pesë anëtarëve të saj, secilit nga një krahinë. Kjo qeveri e parë greke u vendos në Misolongji dhe u kryesua nga fanarioti Mavrokordatos, më 18 janar 1822 shpalli pavarësinë e Greqisë.<sup>965</sup>

Qeveria e Misolongjit nuk e pati të gjatë. Ishin ngatërresat e brendshme si dhe rivalitetet midis grupeve të ndryshme, që e sollën para dështimit. Kollokotroni i pakënaqur me fanariotin Mavrokordatos, thirri një asamble të dytë në Astro, ku edhe i qëroi hesapet me Mavrokordasin (e arrestoi). Me këtë rast, fitues doli një Arvanit tjetër, G. Kundurioti, i cili, pasi e shkarkoi Kollokotronin nga çdo post komandues, qeverinë e vendosi në Krainidhi, përballë ishullit Speca, kryesisht të banuar me Arvanitët, të cilët edhe ashtu ndodheshin në krye të kryengritjes.

Por, as qeveria e Species nuk ia doli të legjitimohej nga shkaku se tashmë kishte plasur një luftë e hapur midis dy rrymave të brendshme rivale: asaj të Peleponezit dhe Greqisë Kontinentale dhe Ishujve, ku Arvanitasit ishin me ndikim

---

<sup>963</sup> Finlay, George: “*A History of Greece from Its Conquests by the Romans to the Present Time*”, Oxfordm 1877, vol. VI, faqe 218-219.

<sup>964</sup> Shih Castellán, Georges: “*Histori e Ballkanit*”, Tiranë 1991, faqe 283.

<sup>965</sup> Shih gjerësisht: Finlay, George: “*A History of Greece from Its Conquests by the Romans to the Present Time*”, Oxfordm 1877, vol. VI.



të madh, meqë ata drejtonin flotën detare si dhe mbanin shumë ishuj, të cilët ishin në gjendje që t'i bënin rezistencë të denjë ushtrisë osmane.

Në këto rrethana, pasi që e kishte shuar kryengritjen e Ali Pashë Tepelenës, Sulltan Mahmuti II, duke parë se përçarjet e brendshme midis kryengritësve po ashpërsoheshin duke hapur mosbesim në disa qarqe, vendosi që t'i jepte një përgjigje të merituar kryengritjes greke. Por, këtë herë thirri në ndihmë vasalin e tij Mehmet Aliun, pashain e Egjiptit, i cili tashmë ndodhej në Kretë, ku kishte ndërhyrë, pasi që ky ishull i ishte premtuar që të përfshihej në pashallëkun e tij bashkë me premtimin se i biri, Ibrahim, do të emërohej guvernator i Moresë, i cili u vendos atje dhe nisi përgatitjet për veprimet e mëtutjeshme në përputhje me marrëveshjet me sulltanin. Në vitin 1825 Ibrahim zbarroi në Peloponez. Kryengritësit grekë nuk ishin në gjendje t'i bënin ballë ushtrisë së tij të modernizuar dhe të përgatitur ushtarakisht nga këshilltarët francezë. Zbarkimi i suksesshëm i Ibrahimit në Peloponez u përcoll edhe me veprimet ushtarake të ushtrisë osmane në pjesën veriore të vendit, të cilat, pa ndonjë vështirësi, një nga një, thyen të gjitha vatrat e kryengritësve. Në prill 1826 ra Misolongji, ndërsa në qershor të njëjtin fat e përjetoi edhe Akropoli i Athinës.

Edhe pse kryengritësit grekë pësuan disfatë të rëndë, megjithatë ishte ndërhyrja europiane, e cila jo vetëm që nuk lejoi që Perandoria Osmane të ndjehet fituese në këtë situatë, por bëri çmos deri sa i dha jetë shtetit të ri të krishterë - Greqisë.

Natyrisht se lindjes së një shteti të tillë, siç u pa, prej kohës i ishte krijuar platforma në përputhje me skenarin rus, por edhe të fuqive të tjera europiane: Austro-hungarisë, Anglisë dhe Francës, plane këto që ishin paraprirë nga atmosfera e lindjes së filohelenizmit e mbështetur mbi sfondin e antikitetit, ku Grekëve u njiheshin meritat e tij, gjë që krijimi i shtetit grek duhej të paraqiste një si shpagim ndaj kësaj “merite civilizuese”. Kjo bëri që shumë nga shkrimtarët dhe poetët e njohur të kohës (Gëtë, Bajron, Shatobrian, e të tjerë)<sup>966</sup> t'i jepnin mbështetje kësaj ideje dhe madje, apelet e tyre të përcillen edhe me vullnetarë europianë në atë luftë, edhe pse shumë prej tyre do të zhgënjehen sapo të bien në kontakt me një vend i cili ishte shumë larg me parafytyrimet që ata kishin për antikitetin klasik.<sup>967</sup>

---

<sup>966</sup> Poeti i madh anglez, Lord Bajron, ishte ndër të parët që iu bashkua kryengritjes greke. Në Janinë ai u takua me Ali Pashën dhe lidhi një miqësi me të, që e pasqyroi edhe në veprën e tij poetike “*Udhëtimi i Çajl Heroldit*”, ku Shqiptarët dhe Shqipëria paraqiten me një pamje romantike si një popull fisnik, bujar dhe luftëtar. Është meritë e këtij shkrimtari të madh që revolucioni grek u pasqyrua objektivisht, duke u parë edhe roli i madh i Shqiptarëve (Arvanitëve) në të. Vdiq më 1823 në Misolongjin e rrethuar nga sëmundja e kolerës.

<sup>967</sup> Castellán, Georges: “*Histori e Ballkanit*”, Tiranë 1991, faqe 285.

Pavarësisht përfytyrimeve për antikitetin klasik, që vazhduan edhe më tutje në gjithë Europën, kryengritja greke ndoqi skenarët që e frymëzuan dhe e prodhuan. Kështu, Rusia, që kishte krijuar “Hetarinë” dhe ia kishte lënë armët në dorë, me ardhjen e Nikollës II në pushtet (kishte zëvendësuar në fron Aleksandërin I pasi që kishte vdekur papritur në dhjetor 1825), bashkë me Anglinë, doli me projektin për ndërmjetësimin e fuqive të mëdha në këtë konflikt mbi bazën e krijimit të një shteti grek autonom sipas modelit të Principatave Danubiane. Një vitin më vonë, cari rus, nëpërmes një ultimatumit Perandorisë Osmane duke kërkuar që ndaj Moldavisë, Vllahisë dhe Serbisë të zbatonte dispozitat e nenit 8 të Traktatit të Bukureshtit, u përpoq që presionin ndërkombëtar ndaj Portës rreth Greqisë ta shfrytëzojë që këto krahina të viheshin nën protektoratin rusë, fakt ky që do të ishte i papranueshme për Anglinë dhe Francën. Për ta penguar këtë, nxituan që bashkë me Rusinë, të nënshkruanin Traktatin e Londrës të korrikut 1827, që rimerrte bazat e protokollit të Shën Petërburgut: ndërmjetësimin dhe krijimin e një shteti grek autonom në kuadrin e Perandorisë Osmane.<sup>968</sup>

Londra si arenë e traktateve për krijimin e shtetit grek (tri sosh nga i pari i vitit 1927 e deri te i treti 1830), tregoi qasjen komplekse të fuqive të mëdha europiane ndaj saj, e cila, krahas pajtimit në parim, përshtohej nga interesa të ndryshme, jo rrallë të mbarsura edhe me kundërtënie dhe prapaskena të shumta, që mund të shkonin edhe deri te shpërthimet ndaj njëra-tjetrës.

Më në fund, pas disfatës së Navarinos, kur Perandoria Osmane humbi thujse pjesën më të madhe të flotës detare si dhe largimit të ushtrisë së Mehmet Aliut të Egjiptit nga Peloponezi, si dhe pas luftës ruso-osmane të vitit 1829 prej nga Perandoria Osmane doli e dobësuar, tri fuqitë e mëdha, duke i dhënë garanci mbrojtjeje Sulltanit nga Mehmet Aliu i Egjiptit dhe përkushtimi që të merrte fronin e Perandorisë, ushtritë e të cilit ndodheshin në Siri, detyruan Portën të pranonte Protokollin e Londrës, që u sanksionua në shkallë ndërkombëtare si traktat në Londër më 3 shkurt 1830, që krijonte një shtet grek ende vasal të sulltanit, me një qeveri që i besohej një mbreti të zgjedhur nga tri fuqitë e mëdha dhe me një territor që kufizohej nga vija Arta-Vollos, si kufi midis Greqisë dhe Perandorisë Osmane.<sup>969</sup>

Edhe pse shteti grek do të kalojë nëpër disa faza tepër të vështira të mosmarrëveshjeve të brendshme që në disa raste morën përmasat e luftës qytetare, nga shkaku se nuk ishte produkt i një lidhjeje të natyrshme i strukturave të ndryshme etnike, sociale dhe gjuhësore, të ndryshme me njëra tjetrën, por pjesë e një projekti

---

<sup>968</sup> Po aty, faqe 286.

<sup>969</sup> Po aty, faqe 287.

nga jashtë, që kishte anashkuar këta faktorë dhe veçoritë e tyre, megjithatë në korrik të vitit 1832 pranoi pavarësinë e Greqisë kundrejt pagimit të shpërblimit prej 13 milion frangash ar. Në shkurt të vitit 1833 Ottoja i Bavarisë – i helenizuar – i zgjedhur nga tri fuqitë e mëdha – vinte këmbën në mbretërinë e tij të re, në një shtet të ri krishterë, Greqinë e pavarur, që dilte kështu në dritë në Ballkan.<sup>970</sup>

Autonomia e Serbisë dhe pavarësia e Greqisë, si fakte të reja në hartën politike të pjesës europiane të Perandorisë Osmane, vunë në lëvizje të drejtpërdrejt thujtëse që të gjithë Shqiptarët brenda dhe jashtë, ngaqë këto dy vende, ndonëse të krijuara nga roli i madh i të krishterëve shqiptarë, pas pak shpallën platformat e tyre kombëtare hegjemoniste: Serbët “*Naçertanjen*” dhe Grekët “*Me-gali idenë*”, të cilat ndërlidheshin me ta si popull dhe hapësirën e tyre etnike, ku ata në të njëjtën kohë rrezikoheshin dyanshëm. Ndonëse që të dyja këto programe nacionale u shfaqen në të njëjtën kohë (mesi i vitit 1844) dhe mbështeteshin në ekspansionizëm hegjemonist, ato nuk ndryshonin për nga qëllimet antishqiptare, por vetëm nga strategjia e veprimit dhe mjetet që do të përdornin, ku Serbët shfaqeshin në rolin e Piemontit të pansllavizmit në Ballkan dhe për këtë kishin mbështetjen e drejtpërdrejt të Rusisë, pa përjashtuar këtu edhe atë të Francës, që shfaqej si më e matur në raport me interesat e popujve të tjerë dhe ato të fuqive të mëdha në rajon, ndërsa Grekët përqendroheshin tek feja ortodokse dhe motoja “kush është ortodoks, është grek dhe kush është grek është ortodoks”, mbi të cilën pastaj me anën e helenizimit në kuadër të helenizimit i ndërtonin planet hegjemoniste, që do të vihen në veprim që nga krijimi i shtetit grek e tutje, kryesisht në dëm të faktorit ortodoks shqiptar, që shfaqej si shumicë në Epir, More dhe Athinë, në bërthamën e shtetit grek.

Perfiditeti i helenizimit me anën e helenizimit, fillimisht nuk u kuptua si duhet nga Shqiptarët ortodoksë, të cilët do të inkuadrohen me shumë përkushtim në luftërat nga vitet 1822-1829, që do të çojnë te pavarësia e Greqisë. Madje, do të jenë edhe disa nga rilindasit e rëndësishëm, të merituar shumë për zgjimin kombëtar shqiptar dhe përhapjen e shqiptarizmit, si Thimi Mitko dhe të tjerë, të cilët fillimisht tek helenizmi do të shohin një bashkëveprues, ose mbështetës të shqiptarizmit sa të identifikohen me atë rrymë dhe mbi të të ndërtohen edhe plane për shtet të përbashkët të të dy popujve, ngatërrim ky që te disa qarqe të caktuara politike dhe intelektuale shqiptare, në forma të ndryshme, do të vazhdojnë deri në prag të pavarësisë. Kështu që, gjatë trajtimeve të mëtutjeshme, Shqiptarëve do t’u

---

<sup>970</sup> Po aty, faqe 288.

duhet të derdhin bukur shumë mund që të tërhiqet vija e qartë midis helenizmit dhe të shqiptarizmit dhe madje ato të vihen në të njëjtit binarë të kundërshtimisë me islamizmin. Sepse, vetëm ashtu lëvizja kombëtare qartësonte mjegullën nga brenda dhe nga jashtë që ia krijonte “*Megali ideja*” greke dhe kurthi i ortodoksisë i cili, në planin kulturor, shoqëror dhe atë politik, ishte i ngjashëm me atë të islamizmit.<sup>971</sup>

Këtu në të vërtetë duhet parë edhe ndikimet që do të kenë Serbët tek popujt tjerë sllavë të Ballkanit drejt nxitjes së lëvizjeve të tyre për pavarësi, si dhe vështirësitë që do të krijojë helenizimi i mbështetur mbi bazat e “*Megali idesë*”, veçmas tek bullgarët dhe Shqiptarët, si dhe pasojat që do të lindin kur Perandoria Osmane, pasi që ta kuptojë idenë rrënuese të saj, do të lejojë *ekzarkatin* bullgar,<sup>972</sup> me të cilin praktikisht do të hapet çështja e pavarësisë së Bullgarisë, por edhe ajo e Maqedonisë si një krizë e paraprogramuar.<sup>973</sup> Sepse, ekzarkati dhe realitet që do të prodhojë ndarja kishtarë do të nxisë një rivalitet të ashpër dhe shumë të rrezikshëm në pjesën europiane të Perandorisë Osmane, veçmas në vilajetin e Selanikut dhe atë të Manastirit, me popullatë të përzier, ku shumicën e përbënin Shqiptarët dhe Bullgarët, po ku kishte grekë dhe pak serbë fund e krye të instrumentalizuar nga Beogradi dhe projekti i tyre për “rikthimin e Serbisë së vjetër” në përputhje me mitin e Kosovës, të cilët luftonin që mbetja osmane të plaçkites jashtë kriterëve etnike, prirje kjo që kryesisht shkonte në dëm të Shqiptarëve.

## KRYENGRITJA E DËRVISH CARËS

Fundi i rebelimit të pashallarëve shqiptarë: Bushatlive të Shkodrës dhe Ali Pashë Tepelenës, në njërën anë dhe pavarësia e Greqisë e ngritur kryesisht mbi kryengritjen e faktorit ortodoks shqiptar në të si dhe krijimi i Serbisë autonome, në tjetrën anë bashkë me shpalljen e Reformave të Tanzimatit në Shqipërinë e Veriut në vitin 1843, u përcollën me një valë kryengritjesh, që morën shtrirje të gjerë. Arsyeet për kryengritje ishin të drejtpërdrejta, meqë zëvendësimi i funksionarëve shqiptarë

<sup>971</sup> Frashëri, Mehdi: “*Historia e lashtë e Shqipërisë*”, Tiranë 2012, faqe 35-38.

<sup>972</sup> *Ekzarkati* (mëkëmbësi e mbretit në Bizant). Porta e Lartë lejoi Ekzarkatin bullgar të pavarur nga patriarku rum, me çka pra ortodoksët bullgarë të ndaheshin nga mbikëqyrja e Patrikanës ekumene të Stambollit, të mbikëqyrur nga Grekët. Ky vendin i Portës së Lartë i vitit 1870, ndonëse i natyrës fetare, sillte ndryshime të mëdha, meqë bullgarët me të fitonin të drejtën e kishës së tyre autoqefale dhe të shprehjes së identitetit fetar jashtë ndikimit grek, i cili deri më atëherë ishte i fuqishëm dhe barazonte identitetin fetar me atë kombëtar, pikërisht në përputhje me “*Megali idenë*”, do t’ia dalin që t’i përshpejtojnë proceset e pavarësisë kombëtare.

<sup>973</sup> Shih: Buxhovi, Jusuf: “*Kosova*” I-V, libri III - Perandoria Osmane, Prishtinë, 2015, faqe 80-88.

me nëpunës të huaj si dhe urdhri për rekrutimin e ushtarëve nizamë, preknin interesat e tyre ekzistenciale për rrethanat. Rekrutimi i ushtarëve nizamë, në një kohë zgjatjeje nga 5 deri në 15 vjet, pos që i dëmtonte familjet, përcillej edhe me rrënimin e strukturave ushtarake vendore (bashibozukëve), të cilët ishin në shërbim të feudalëve vendorë, të cilët, me anën e tyre mbronin autonominë e tyre, të vendosur në kudër të sistemit vetëqeverisës (një lloj autonomie krahinore) që Perandoria Osmane kishte lidhur me shqiptarët nga fillimet, ku Kanuni rregullonte jetën e brendshme si dhe raportet e pronës. Kjo marrëveshje kishte mundësuar që pjesa më e madhe e shqiptarëve, sidomos Veriu, të ruajë vetëqeverisjen e brendshme si dhe etninë, prej nga kishte burimin edhe forca e feudalëve vendorë, të cilët, në rrethanat e reja, siç ishte parë me rastin e pashallëkut të Shkodrës dhe të Janinës, ishin kthyer në lëvizje të gjera për autonomi e deri te shkëputja prej Portës së Lartë.

Reformat e Tanzimatit, në emër të ndryshimeve të thella shoqërore dhe politike, të imponuar nga fuqitë e mëdha, duhej të luftonin pikërisht faktorët që Perandorinë Osmane e kishin kthyer në peng të këtyre forcave, ndër të cilët rrënimi i feudeve autonome dhe fuqisë së tyre ushtarake të mbështetur mbi rendin e jeniçerëve si dhe bashibozukët, shfaqej si kushti i parë, gjë që nënkuptonte konfrontimin me këto struktura. Ky zhvillim, që nënkuptonte edhe ndryshimet e mëdha në strukturën administrative, ku në emër të parimit të barazisë së të gjithë qytetarëve para ligjit dhe lirive të tyre parashihej edhe përfaqësimi i atyre që deri më dje kishin qenë të pabarabartë (rajës – popullatë së krishterë), në administratë, polici e të tjera, pashmangshëm kalonte nëpër rasformimin e strukturave ushtarake feudale (bashibozukëve), që paraqitnin shtyllën kryesore të feudalëve vendorë dhe të fuqisë së tyre dhe kthimin e tyre në ushtri të rregullt në përputhje me rrethanat e reja. Kjo do të thoshte konfrontim i dyfishtë: me feudalët vendorë, të mbështetur mbi sistemin e spahinjve si dhe me formacionet vendore ushtarake, të lidhura ngushtë me feudalët dhe pagat që merrnin prej tyre, të cilët privoheshin nga fuqia që kishin.

Natyrisht se prekja e këtyre strukturave lokale që kishin fuqi ekonomike dhe ushtarake dhe mbikëqyrnin gjithë pushtetin vendor, e përcjellë edhe me fushatën për zëvendësimin e zyrtarëve vendorë me nëpunës të tjerë (kryesisht të dërguar nga qendra, e ku kishte edhe pjesëtarë të pakicave), që përcillej me krijimin e një pasigurie dhe druajtjen se Perandoria, me njohjen e shteteve të pavarura dhe autonome (Greqisë, Serbisë e të tjera), kishte filluar t'i tradhtonte interesat e shqiptarëve, luante rol të madh në mobilizimin e popullatës kundër këtyre ndryshimeve. Kjo u

pa fare mirë në verën e vitit 1843, kur në disa qytete të veriut, fillimisht në Prizren e pastaj në Gjakovë, Pejë, Prishtinë dhe gjetiu, u dëbuan nëpunësit e rinj turq.<sup>974</sup>

Reagimet e tilla të popullatës në disa qytete veriore, nuk ndalën veprimet e Portës së Lartë për t'ua imponuar shqiptarëve reformat. Meqë dëbimi i nëpunësve të rinj turq nuk u përcoll me ndonjë veprim tjetër të organizuar, e as me ndonjë organizim të ndërlidhur të përmasave të gjera, siç kishte ndodhur në Shkodër para gjashtë vitesh, kur pas protestave të mëdha kundër rekrutimit, Perandoria përkohësisht kishte ndërprerë këto veprime, ushtria osmane në këto pjesë nuk e kishte të vështirë t'i shtypte ato. Ngjashëm ndodhi edhe me disa reagime të shkëputura në drejtim të Lumës, të cilat u shuan me të shpejtë, gjë që fitohej përshtypja se leksioni që kishin marrë shqiptarët me rastin e shtypjes së kryengritjes së pashallëkut të Shkodrës të drejtuar nga Bushatliu dhe ato në jug nga Ali Pashë Tepelena, shqiptarët i kishte lënë pa ndonjë fuqi vepruese të përmasave të mëdha, siç pritej.

Por, kur vlerësohej se zbatimi i reformave në veri të Shqipërisë do të ecte disi dhe se nga burime të ndryshme mund të kuptohej se në disa pjesë, përkundër vështirësive, po vazhdonte me sukses rekrutimi i banorëve të zonave kryengritëse për armatën e re osmane, që dërgoheshin nga Selaniku për në Stamboll,<sup>975</sup> doli se një zonë tjetër, ajo e Maqedonisë Perëndimore, me kryeqendër Shkupin, ishte kthyer në një vatër të kryengritjes, që do të përhapet me të shpejtë edhe në pjesët e tjera për të arritur përmasa shumë të mëdha dhe shqetësuese madje, ngaqë ato shfaqeshin të organizuara dhe me kërkesa politike.

Fjala ishte për kryengritjen e Dërvish Carës, e cila filloi në Gostivar në nëntor 1843 dhe brenda dy-tre muajsh u zgjerua në pjesë të ndryshme të vendit. Kryengritja e Dërvish Carës u lidh me ardhjen e forcave osmane nën drejtimin e Hajredin Pashës, i cili kishte marrë përsipër rekrutimin e ushtarëve të rinj, të shumtën me forcë, gjë që shkaktoi revolta të shumta.

Në të vërtetë, kryengritja e Dërvish Carës, që shpërtheu në verën e vitit 1843, ndonëse u mor si reagim ndaj fushatës së Hajredin Pashës, ajo u ushqye nga zhvillimet e dy-tre viteve të fundit, kur Porta e Lartë, në kuadër të qërimit të hesapeve me pashallarët vendorë, që kishin filluar t'u bënë rezistencë reformave të Tanzimatit, likuidoi pashallarët tetovarë, vëllezërit: Hivzi Pasha në Shkup, Hysein Pasha

---

<sup>974</sup> "Historia e Popullit Shqiptar", II, Tiranë, 2002, faqe 92.

<sup>975</sup> Shih raportin e konsullit anglez në Selanik, H. Lejard te 23 majit 1843, drejtuar Londrës te Matkovski, Aleksandar "Kryengritja e Dërvish Carës", Tetovë, 2012, faqe 48. Aty bëhet fjalë për një kontingjent prej 700 shqiptarësh, të cilët, me anijen "Jeni dunja", niseshin nga Selaniku për në Stamboll.

në Qystendil dhe Abdurrahman Pasha në Tetovë, të cilët qeverisnin në mënyrë gjysmë të pavarur.<sup>976</sup>

Edhe pse thuhet se vëllezërit pashallarë ishin thirrur në Stamboll nga shkakut i një konflikti që kishin rreth pronave, megjithatë, ata u burgosën, pse nuk pranuan që të përfshihen në fushatën e mbledhjes së rekrutëve në pjesët që qeverisnin. Kështu që dy të parët u internuan për në Anadoll, ndërsa Hivzi Pasha vdiq në burg, në vitin 1843, pas një helmimi.<sup>977</sup>

Lajmi për vdekjen e Hivzi Pashës, u prit me shpërthimin e kryengritjes së Dërvish Carës, i cili ishte i afërm i Hysein Pashës. Pas eliminimit të Abdurrahman Pashës dhe zëvendësimit të tij me të vëllanë, Xheladin Beun, forcat lokale ndaj pashës së eliminuar (bashibozukët dhe të tjerët që kishte nën mbikëqyrje), zunë t'u bishtojnë urdhrave për rekrutim. Ndër këto njësite, ishte edhe njëri, që drejtonte Dërvish Cara, i cili nga Xheladin Beu u emërua komandant i forcave të rendit në Gostivar. Por, Dërvish Cara, në vend se të zbatonte urdhrat e Xheladin Beut për të mbledhur rekrutë, bëri të kundërtën. Me përkrahësit e tij të shumtë nga radhët e bashibozukëve, të cilët kërkonin që të ruanin pozitat e tyre ndaj ushtrisë së rregullt, kundërshtoi ligjet e sulltanit. Në Gostivar, i rrethuar nga përkrahës të shumtë, të gatshëm që të rikthenin rendin e vjetër ushtarak, shpalli padëgjueshmërinë kundër Portës dhe “u shpall mbret i bashibozukëve të shumtë”.<sup>978</sup>

Nga Gostivari, Dervish Cara u nis për në Tetovë. Në hyrje të saj u ndesh me mercenarët e Xheladin Beut, të cilët, i bënë një rezistencë të fuqishme, por pas disa ditësh, pas një rrethimi të plotë nga të gjitha anët, bashkë me Beun, u larguan në drejtim të Shkupit. Në Tetovë, Dervish Cara ngriti qendrën e kryengritësve si dhe kërkoi nga sulltani që të shfuqizonte urdhrin për marrjen e rekrutëve. Në të kundërtën, kërcënonte se do të nisej drejt Stambollit.<sup>979</sup>

Marrja e Tetovës nga kryengritësit si dhe vendosja e rendit nga ana e tyre, ngjalli reagimet e atyre që tashmë ishin përcaktuar kundër reformave dhe ishin të gatshëm që t'i bashkoheshin lëvizjes së Dervish Carës. Nga pjesë të ndryshme, Tetovës ia mësynë njësi të shpëputura të bashibozukëve dhe mercenarë të feudallëve të shpronësuar. Vlerësohet se brenda disa ditësh trupat e Dervish Carës arritën në 4 mijë veta, në mënyrë që në vigjilje të mësymjes së Shkupit, nga konsulli aus-

---

<sup>976</sup> Matkovski, Aleksandar: “Kryengritja e Dërvish Carës”, Tetovë, 2012, faqe 54-56.

<sup>977</sup> По ату.

<sup>978</sup> По ату.

<sup>979</sup> Тосковски: “Зборник на народни уомворенија, наука и книзнина“, Софје, 1894, с. 418-420.

triak, Ippen, vlerësoheshin në 10 mijë veta.<sup>980</sup> Në Shkup, kryengritësit e Dervish Carës vunë rend dhe prej andej, i dërgonin kërkesa Stambollit për heqjen dorë nga rekrutimet. Tubimi i kryengritësve në Shkup, vuri në lëvizje edhe bashibozukët dhe forcat e tjera kryengritëse – kundërshtarë të rekrutimit, në anën e Kumanovës dhe të Kosovës. Në Kumanovë, tashmë ishin formuar grupet kryengritëse, që kishin filluar të merrnin qendrën e qytetit. Në krye të tyre gjendej Bajram Vaksiçani, i cili Dërvish Carën e pranonte për “komandant të përgjithshëm”. Në Kumanovë, kryengritësit, krahas kundërshtimit të reformave të armatës së re, njëherësh kërkonin edhe ndërprerjen e të gjitha reformave administrative dhe politike. Në radhët e tyre kishte edhe fanatikë fetarë, të cilën kërkonin që Perandoria t’i kthehej në tërësi shariatit.<sup>981</sup>

Marrja e Kumanovës u përcoll edhe me depërtimet e reja në drejtim të Kriva Pallankës dhe të Vranjës. Në Kriva Pallankë, kryengritësit nuk hasën në ndonjë rezistencë. Aty, iu bashkuan edhe njësi të tjera të shkëputura të bashibozukëve, që kërkonin të rikthenin pushtetin e dikurshëm, ose që ishin në shërbim të feudalëve vendorë, refuzues ndaj reformave të Tanzimatit. Në Vranjë, kryengritësit hynë më 12 prill.

Në të njëjtën kohë, kryengritjet shpërthyen edhe në pjesën e kazasë së Prishtinës (në Prizren dhe Gjakovë) dhe në atë të Shkodrës. Edhe këtu kryengritësit përsëritën kërkesat kundër reformave dhe rekrutimit me kërcënimin se do të bashkohen për një sulm të përbashkët kundër Stambollit. Gjatë verës, kryengritësit morën edhe Dibrën dhe Matin.

Përkundër këtyre sukseseve afatshkurtra, që mund t’i atribuohen rebelimit të pushtetit vendor ndaj qendrës si dhe ndikimit të madh të këtij të parit në raport me të parin, mbesin të paqarta lidhjet organizative të kryengritësve rreth një qendre të përbashkët ndërkrahinore, kështu që fitohet përshtypja se ato pasqyrojnë revoltë të grupeve të caktuara nga formacionet ushtarake të feudalëve në shturje e sipër, që humbnin punën po edhe ndikimin që e kishin në kuadër të strukturave të tyre të sigurisë vendore. Nga disa burime bëhet e ditur se kryengritjet në Prishtinë, Gjakovë, Prizren dhe Shkodër, ndonëse të karakterit të njëjtë (kundër rekrutimit dhe reformave), nuk kishin të njëjtin këshill kryengritës, pos që solidarizoheshin mes vete.<sup>982</sup>

---

<sup>980</sup> L. Mile: “Rreth kryengritjës shqiptare në çerkun e dytë të shekullit XIX, e sidomos rreth kryengritjes së Kosovës të vitit 1844”, Studime historike, XX-III,2, Tiranë, 1966, f. 144.

<sup>981</sup> Василевич, Ј.Х.: „Јужна Стара Србија“, I, f.483.

<sup>982</sup> Brestovci, S: “Marrëdhëniet shqiptaro-serbe-malazeze”, Prishtinë, faqe 126.



Edhe përkundër kësaj, shtrirja e kryengritjes nga pjesa e Pollogut në drejtim të Shkupit dhe tutje deri në Leskoc si dhe përhapja e saj në Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Pejë dhe në drejtim të Shkodrës, detyroi qeverinë osmane që të hyjë në bisedime me udhëheqësit e kryengritjes, ku referencë e rëndësishme ishte Dervish Cara, si njëri ndër ata që rreth vetes kishte mbledhur më së shumti bashibozukë dhe forca të tjera të armatosura të gatshme për kryengritje. Bëhet e ditur se gjatë bisedimeve që kishin përfaqësuesit e qeverisë osmane me Dervish Carën po edhe me disa prijës të tjerë në Prishtinë, Prizren, Gjakovë e gjetiu, kryengritësit kryesisht kërkonin anulimin e ligjit për shërbimin e detyrueshëm ushtarak si dhe zëvendësimin e funksionarëve osmanë të pushteti lokal që nuk e dinin gjuhën shqipe. Në disa burime shfaqej edhe kërkesa që të njihej edhe autonomia e Shqipërisë, në suazat e Perandorisë Osmane, ashtu siç ishte njohur autonomia e Serbisë, më 1830,<sup>983</sup>kërkesë kjo që nuk pasqyrohet në ndonjë dokument meritor, pos si e përfolur nëpër raportet e konsujve në mënyrë të paqartë.<sup>984</sup>

Përkundrazi, gjatë bisedimeve që kishte me Dervish Carën dikur afër Katllanovës ndërmjetësuesi britanik, Austen Henry Layardi autorizuar nga Omer Pasha, del se Cara, kishte përsëritur kërkesën për anulimin e ligjit për shërbimin e detyrueshëm ushtarak, por kishte premtuar se, sipas mundësisë, sulltanin do ta furnizojnë me trupa të parregullta ushtarake, por të komanduara nga një komandant i tyre”.<sup>985</sup>

Bisedimet me kryengritësit si dhe misionet ndërmjetësuese të diplomatëve të huaj, si ai i Layardit, gjatë verës së vitit 1844, Perandoria Osmane i kishte shfrytëzuar për përgatitjen ushtarake që t’i qërojë hesapet me kryengritësit pasi që t’i këtë bërë disa përpjekje që t’i përçajë mes veti duke joshur disa prej tyre në mënyra të ndryshme. Natyrisht se ofensiva që kishte përgatitur Omer Pasha në fillim të pranverës u kishte shërbyer edhe nevojave të brendshme si dhe atyre të jashtme të Portës, që në njërin anë të demonstrojë gatishmërinë, që të vazhdohet fushata ndaj strukturave të shkapërderdhura të jeniçerëve dhe të bashibozukëve me të cilat nuk kishte më pajtim, sidomos në vilajetet shqiptare ku kishin mbështetje nga feudalët vendorë që refuzonin reformat e Tanzimatit, dhe në tjetrën anë, të jepnin dëshmi

<sup>983</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, II, Tiranë, 2002, faqe 92.

<sup>984</sup> Matkovski, Aleksandar: “*Kryengritja e Dervish Carës*”, Tetovë, 2012, faqe 223-226.

<sup>985</sup> Shih memoaret e diplomatit britanik Austen Henri Layard (1817-1894) “*Autobiography and Letters from his Childhood until his appointment as H. H. Ambassador at Madrid*”, vol. I-II, London, 1903, ku ai bën fjalë për misionin e tij ndërmjetësues tek kryengritësit shqiptarë (te Dervish Cara), i autorizuar nga Omer Pasha, me ç’rast në mënyrë decisive ndër shkaqet kryesore të kryengritjes përmend të dhënë se “kryengritësit nuk pajtohen të japin trupa të rregullta dhe nuk duan të zbatojnë asnjë reformë të re që Porta dëshiron t’i zbatojë në ato vise”.

para fuqive të mëdha, të cilat kërkonin zbatimin e reformave me ngut, se ato do të bëheshin, por që nuk duhej nxituar gjithaq, ngaqë rrezikohej stabiliteti i vendit, po qe se çdo gjë do të shikohej nëpërmes armës.

Natyrisht se gjatë kësaj kohe, Omer Pasha kishte përgatitur në Manastir një kontingjent prej 32 mijë ushtarësh, që do të merrnin pjesë në fushatën e gjerë, e cila, krahas eliminimit të forcave kryengritëse (bashibozukëve dhe njërive të tjera feudale) do të merrej edhe me rekrutimin e dhunshëm aty ku ai ishte refuzuar. Nga mesi i majit 1844, njësitë elite të ushtrisë osmane, të komanduara nga Omer Pasha iu drejtuan Shkupit, Tetovës, Kumanovës e Karadakut të Shkupit. Krahas pararojave përdori artileri dhe njësi të tjera malore, të cilat për ditë të tëra vunë në shënjestër pozicionet e kryengritësve. Në pamundësi të një ballafaqimi frontal, forcat kryengritëse u tërhoqën nga këto qytete në drejtim të Grykës së Katllanovës. Nga 13-17 maj 1844, në këto pjesë u zhvilluan luftime të ashpra. Më 18 maj, pas një përleshjeje të përgjakshme, në afërsi të Banjës së Katllanovës, kryengritësit u detyruan të tërhiqeshin. Pas tri ditësh, ushtria osmane mori Shkupin dhe riktheu administratën e vet. Me këtë rast, shumë nga kryengritësit e burgosur, të arrestuar u dërguan në Stamboll.<sup>986</sup>

Ofensiva e ushtrisë osmane vazhdoi gjatë gjithë verës. Njësitë ushtarake të Omer Pashës, nga Shkupi u drejtuan kah Tetova, Gostivari, Kumanova si dhe Presheva, Bujanovci dhe Vranja, ku rikthyen pushtetin osman. Në të njëjtën kohë, një pjesë e ushtrisë së Omer Pashës, nga Kaçaniku iu drejtua Prishtinës dhe prej andej vazhdoi për në Prizren, Gjakovë, Pejë e deri në Shkodër. Veprimet e ushtrisë osmane kundër kryengritësve si dhe qendrave të tyre që u shpartalluan ose u detyruan të largohen në pjesët malore, u përcollën me burgosje të shumta si dhe me mobilizim të dhunshëm të rekrutëve, të cilët në drejtim të Shkupit, nga Selaniku, niseshin për në Stamboll.<sup>987</sup>

Kur dukej se gjendja ishte qetësuar paksa dhe se Porta e Lartë kishte thyer forcën e kryengritjes shqiptare, e me këtë, si thuhej, së paku formalisht, u kishte hapur udhë edhe reformave në ato anë, ku fuqitë e mëdha përcillnin me vëmendje “gjendjen e popullatës së krishterë”, prej nga “vinin njoftime shqetësuese”, megjithatë, kryengritjet “e shkëputura” do të kthehen në pjesën e Dibrës. Në nëntor, dibranët thirrën një kuvend (në fushën e Gjoricës) të drejtuar nga Sheh Mustafa Zerqari, ku u kërkuua mbrojtja e të drejtave autonome që gëzoheshin prej kohësh.<sup>988</sup>

---

<sup>986</sup> “Historia e Popullit Shqiptar” II, Tiranë, 2002, faqe 93.

<sup>987</sup> Po aty.

<sup>988</sup> Po aty.

Kryengritësit dibranë, të drejtuara nga Cen Leka, në Gjoricë, ia zunë pritën forcave të Hajredin Pashës. Buzë Radikës u zhvillua një betejë e përgjakshme, me shumë humbje, sidomos për ushtrinë osmane. Edhe përkundër kësaj, kryengritësit dibranë nuk ishin në gjendje të mbanin vijat e frontit, ngaqë ushtritë osmane, përballonin humbjet me forca të reja, ndërsa ata nuk mund ta bënë këtë, kështu që shumë prej tyre u tërhoqën.

Kryengritja u rikthye edhe në viset malore të Rekës së Gjakovës, në ato të Bytyçit, të Tropojës, Gashit dhe të Krasniqes. Ajo udhëhiqej nga Binak Alia dhe Sokol Arami. Disa mija kryengritës, në maj 1845 çliruan Gjakovën me rrethinë. Pas një muaji, u detyruan të largohen prej andej ngaqë forcat e shumta ushtarake osmane ia vunë rrethin gjithë vendit, prej nga filluan një fushatë të madhe spastrimi. Me këtë rast, Mehmet Reshit Pasha, në ato pjesë burgosi mbi një mijë veta. Por, një pjesë prej tyre, bashkë me dy mijë të tjerë, që gjendeshin në burgjet e Stambollit dhe pjesët e tjera të Anadollit, sulltani i amnistoi.

Edhe pse Qeveria Osmane shtyu për një kohë zbatimin e reformave të Tanzimatit në kazatë e Prishtinës, të Shkupit dhe të Shkodrës si dhe shpalli dy amnisti, gjatë dy-tri viteve të ardhshme, kryengritjet vazhduan në pjesët e tjera të vendit. Sidomos në jug, ku po ashtu pati fushata të vazhdueshme të ushtrisë osmane, ndaj grupeve komite, gjendje kjo e nderë që ngadalësoi ose në disa pjesë edhe përjashtoi reformat e shpallura të Perandorisë Osmane për një kohë të pacaktuar, me çka, nga jashtë krijohej përshtypja se Stambolli jo vetëm që nuk ishte interesuar që të zbatoheshin ato, nga se ndryshonte karakteri i një shoqërie despotike-obskurantiste, por për më tepër, frikësohej se ato nuk paraqitnin tjetër pos mundësi më shumë që pjesa evropiane të kthehej në pre të ambicieve të mëtutjeshme të vendeve sllavo-ortodokse ndaj kësaj pjese që ushqeheshin me lëvizjet nacionaliste, që tashmë nga serbët, grekët dhe bullgarët ishin kthyer në projekte hegjemoniste.

Se zbatimi ose moszbatimi i reformave të Tanzimatit do të shfrytëzohej njësoj për këto qëllime, këtë e treguan edhe kryengritjet e shqiptarëve ndaj tyre gjatë viteve të fundit si dhe karakteri i tyre që ato të refuzoheshin, refuzim ky që pak nga pak nxori edhe kërkesën që “mbrotja e privilegjeve”, siç dilte nga interpretime të para nga këndvështrime të kundërta, të lidhej me autonominë shqiptare, gjë që për pretendentët hegjemonistë ndaj viseve etnike shqiptare (Serbëve, Grekëve dhe Bullgarëve), shihej si shumë e rrezikshme, por që për rrethanat kjo duhej të anatemohet me “kërcënimin që u vinte të krishterëve nga lëvizja e bashibozukëve shqiptarë”, të cilët kryengritjen kundër reformave e shfrytëzonin kundër popullatës

së krishterë, e me plaçkitje të pronave të tyre, me dëbime si dhe me rrënimin e manastireve ortodokse.<sup>989</sup>

Si do të shihet, ky diskurs kundër shqiptarëve si dhe anatemimi i të gjitha kërkesave të tyre për autonomi, të cilat, pak nga pak do të dalin në pah dhe do të marrin formën e programeve politike gjatë kuvendit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, do të ndikojnë që vilajetet evropiane të Perandorisë Osmane, kryesisht ato shqiptare (i Kosovës, Shkodrës, i Janinës dhe i Manastiri) bashkë me atë të Selanikut të viheshin nën vëzhgim të vazhdueshëm e deri te futja e tyre nën mbikëqyrje ndërkombëtare në fund të shekullit, kur do të dalë në pah edhe Kriza e Maqedonisë, si një krizë politike, e inskenuar nga Serbët, Bullgarët dhe Grekët për të copëtuar etninë shqiptare.

## PANSLLAVIZMI DHE LËVIZJET NACIONALE NË BALLKAN

Që nga reformat e Tanzimatit e këndej, të cilat u sollën nga sulltani Adyl Mexhidi (1839-1861), Perandoria Osmane u hyri përpjekjeve që të modernizohej në të gjitha fushat sipas vendeve të zhvilluara perëndimore. Për këtë ajo kishte fituar edhe përkrahjen e Britanisë së Madhe, e cila, pas largimit përfundimtar të Venedikut nga ujërat e Mesdheut, ku ajo kishte dominuar gjatë pesë shekujve të

---

<sup>989</sup> Rreth gjoja karakterit antisllav dhe antiserb të kryengritjeve shqiptare të viteve të tetëdhjeta të shekullit nëntëmbëdhjetë, gjegjësisht të kryengritjes së Dervish Carës shih: Јован Хаџи Васиљевић: „Јужна Србија I – Област Куманова“, Београд, 1909; „Јужна Србија II - Област Прешево“, Београд 1913 dhe „Скорје и његова околина“, Београд 1930. Në këto botime, Haxhi Vasiljeviqi thuajse të gjitha kryengritjet shqiptare nga kjo kohë e deri në vitin 1912 i sheh me “karakter anisllav dhe antiserb”. Sipas historianit serb, kryengritjet shqiptare kundër Tanzimatit janë të kurdisura pjesërisht nga vetë Porta e Lartë, e cila nuk kishte vullnet të zbatonte reformat si dhe nga Austro-Hungaria, e cila ishte e inresuar që elementin shqiptar, që e quante “të egër dhe pa qytetërim” ta shfrytëzojë për të krijuar “një shtet islamik shqiptar” në Ballkan, që do të ngrihej “në djepin serb – në Kosovë”, shtet ky që do të jetë në përputhje me interesat e Vjenës në Ballkan. Sipas Vasiljeviqit, kryengritja e Dervish Cares, ishte kryengritje kundër serbëve dhe kishave të tyre. Për ta ilustruar këtë, ai sjell shënime të trilluara për qindra serbë të vrarë, të masakruar, për shumë e shumë manastire të rrënuara e të kallura, gjë që demantohen nga raportet e konsujve britanikë, austriakë, francezë, italianë dhe të tjerë që kanë mbikëqyrur nga afër këto zhvillime. Kjo vlen veçmas për diplomatin britanik Henri Layard, i cili ka lënë shumë shënime rreth kryengritjes së Dervish Cares si dhe takimeve që kishte me kryengritësit në disa pjesë, i cili thotë “se raportet rreth masakrave ndaj popullatës serbe ishin të ekzagjeruara dhe ndoshta të pabazuar fare”. Layard sjell edhe deklaratat e kryengritëse shqiptarë rreth atyre që ata i quanin shpifje “duke thënë se nuk kishte asgjë nga ato që thuheshin, ngaqë çdo gjë ishte shpifje nga Turqit, me qëllim të njollosjes së kërkesave të drejta”. Po ashtu, nga deklaratat e kryengritësve merrej vesh se “nga ato që thuheshin për zullumin ndaj të krishterëve nuk kishte asgjë, pos mbledhjes së tatimit nga koha e vënies nën mbikëqyrje” për të cilat ata bsonin “se ishin legjitime, ndaj dhe i mbledhnin prej njerëzve të të gjitha besimeve dhe shtresave”. Diplomati britanik thotë se “kryengritësit në asnjë mënyrë nuk kanë keqtrajtuar të krishterët, të cilët ishin vëllëzrit e tyre dhe të cilët nuk janë shqetësuar kurrë për shkak të besimit të tyre...”

fundit, tashmë shfaqej si fuqi e madhe detare, me pretendimet e qarta që të mbikëqyrte Mesdheun, por edhe rrugët detare që çonin kah India. Për ndryshim nga fuqitë tjera të mëdha europiane, që interesat e tyre ndaj Perandorisë Osmane tashmë i shihnin gjithnjë në përputhje me hesapin kur ajo një ditë nuk do të jetë në gjendje të arrijë limitet e premtuara me çka pastaj fillonte edhe rënia e saj përfundimtare, Britania e Madhe kishte për qëllim mbajtjen e saj në fuqi në mënyrë që të përfitojë, në vend se të përfshihet në një pre për ndarjen e plaçkës së pasigurt në të. Natyrisht, se këtu Britanikët binin në kundërshtim të drejtpërdrejtë me “aleatin” e përkohshëm, Rusinë, e cila bënte çmos që Perandoria Osmane të shembej nga brenda, kryesisht nga lëvizjet nacionaliste në pjesën evropiane të vendeve sllavo-ortodokse që ajo i mbikëqyrte, dhe të përfitohej sa më shumë që të ishte e mundur, por gjithnjë duke pasur parasysh që për këtë të mos futej në konflikt me europianët, në radhë të parë me Austro-Hungarezët, të cilët, po ashtu kishin interesat e veta në këtë çështje dhe ishin të përkushtuar që në përputhje me to të drejtonin edhe këtë zhvillim, paçka ishin të bindur se duhej pasur kujdes edhe për ruajtjen e balancave me të tjerët. Megjithatë, Rusia kishte bindjen nëse do ta joshte Britaninë e Madhe në dëm të pretenduesve të tjerë, Austro-Hungarisë dhe Francës, atëherë do të sendërtohej ëndrra ruse për pushtimin e plotë të Detit të Zi dhe daljen në Detin Mesdhe nëpërmes pushtimit të Bosforit dhe ngushticave të Marmarës, pasi t’i vinte nën mbikëqyrje të përhershme. Në këtë drejtim Car Nikolla, në janar të vitit 1853, thirri në pallatin perandorak vetë ambasadorin anglez të Petrogradit, të cilit do t’ia bëjë me dije:

“Ne kemi përpara një të sëmurë. Një njeri shumë të sëmurë. Do të ishte një ters i madh nëse ai do të na ikte nga duart përpara se të marrim masat e nevojshme”.<sup>990</sup>

Sigurisht se këtu e ka prejardhjen edhe ajo metafora rreth “*të sëmurit të Bosforti*”, e cila do të kthehet në një formulë të veçantë, me të cilën do të shërbehet politika dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha europiane nga ajo kohë e këndeje përderisa në të vërtetë të bjerë Perandoria Osmane përgjithmonë pas tetëdhjetë e sa vitesh.

Edhe pse fjalët e carit rus do të marrin dhenë, megjithatë, atij nuk do t’i pijë ujë që në këtë lojë ta fusë Britaninë e Madhe, përkundër premtimit se nga ky pazar ata do të merrnin Kretën dhe Egjiptin, me çka plotësoheshin kërkesat e tyre që kishin të bënin me ambiciet për t’u forcuar si fuqi e madhe detare.

---

<sup>990</sup> Schevill, Ferdinand: “*Ballkani – historia dhe qytetërimi*”, Tiranë, 2002, faqe 292.

Megjithatë, edhe pse do të refuzohet nga Britaniket dhe, madje, do t'i tërhiqet vërejtja se interesat e saj kërkonin një Perandori Osmane që do të reformohej për ta ruajtur vendin që kishte, cari rus, vazhdoi të kërkonte bashkëveprues, pa ngurruar që të bëjë trysni të drejtpërdrejtë te Perandoria Osmane, që asaj do t'ia vështirësonin rrugën e reformave nga brenda, të shumtën me futjen e ngatërresave nga popullata sllavo-ortodokse dhe lëvizjet e tyre nacionaliste që i mbikëqyrte dhe tashmë me rastin e shpalljes së Greqisë shtet të pavarur dhe të autonomisë së Serbisë dhe të krahinave moldave, ia kishte dalë. Kështu, në mars të vitit 1853, car Nikolla i dërgoi një ultimatum Stambollit, që përfshinte njohjen e të drejtave të kishës greke mbi Tokën e Shenjtë të Palestinës si dhe njohjen e Rusisë si mbrojtëse e të gjithë Grekëve të krishterë në tokën turke. Ultimatumi u paraqit nga princ Menshikov, i njohur për sjelljen e tij harbute ushtarake.<sup>991</sup>

Natyrisht, se Porta e Lartë, pasi që çështjen ia paraqiti Britanisë së Mesdhe, nga Londra me të shpejtë i erdhi përkrahja e plotë. Ambasadori Lordi Stratford, personalisht e siguroi sulltanin se nuk do të lejohet që Porta të humbte sovranitetin ndaj shtetasve të vet. Ndërsa, sa i përket kërkesës që kishte të bënte me Tokën e Shenjtë, meqë kjo nuk përbënte rrezik për Perandorinë, pos që Rusinë e konfrontonte me pretendentët e tjerë për të siguruar të njëjtën, këshilloi që kjo kërkesë të plotësohej.<sup>992</sup>

Me përkrahjen britanike, Porta e Lartë refuzoi kërkesën ruse rreth njohjes së të drejtës që Rusët të jenë mbrojtje të të gjithë Grekëve të krishterë në tokën perandorake, e drejtë kjo që mbi këto baza shtrihej edhe mbi Serbët dhe ortodoksët e tjerë. Kjo bëri që pas pak të prishen marrëdhëniet diplomatike ndërmjet carit dhe sulltanit.

Në të vërtetë, refuzimi i kërkesës ruse përbënte pikën kyçe të ndryshimit ndërmjet politikës britanike për të ruajtur Perandorinë Osmane për aq sa ishte e mundshme dhe në përputhje me interesat e saj dhe politikës ruse për ta shkatërruar atë.

Ky antagonizëm politik shfaqej si shkas i mirë për një luftë të re të ardhshme të Rusisë kundër Perandorisë Osmane, të gjashtës me radhë nga ajo e vitit 1695 që kishte nisur Pjetri i Madh kur kishte pushtuar portin e Azovit dhe në paqen e Karlovicit të vitit 1699 kishte nënshkruar një traktat me sulltanin duke marrë pjesën veriore të Detit të Zi. Për dallim nga luftërat tjera, kur Rusët edhe kur kishin humbur, kishin nxjerrë përfitime të mëdha, siç ishin ato për lejimin e lirë të lundrimit në Danub, pastaj në Detin e Zi e deri te kalimi, me leje, nëpër ngushticat e

---

<sup>991</sup> Po aty, faqe, 292.

<sup>992</sup> Po aty.

Bosforit, këtë herë kërkohej rënia e Perandorisë Osmane me pretekstet se nuk po zbatonte reformat që kishin të bënin me përmirësimin e pozitës së të krishterëve në Perandori, veçmas në pjesën europiane, ku ajo tashmë syrin ua kishte vënë Bullgarëve dhe Serbëve, si mbështetës të saj kryesorë për të shtrirë ndikimin në këtë pjesë vitale prej nga ajo do të shfaqej edhe më e fuqishme.

Meqë kishte edhe vende europiane që së paku nuk do ta kundërshtonin rënien “me shkas “ të Perandorisë Osmane, ndërkohë që interesimin e Britanisë së Madhe për t’u mbështetur sulltani e shihnin si çështje të forcimit të saj të mëtutjeshëm që i rrezikonte ata, dukej se lufta e re midis Rusisë dhe Perandorisë Osmane ishte e pashmangshme, luftë kjo që do të implikonte edhe Britaninë e Madhe, e cila tashmë i kishte dhënë mbështetje të plotë sulltanit që të mos pranonte ultimatumin rus.

Duke dëshiruar që të ngacmojë drejtpërdrejt Portën e Lartë dhe njëherësh të sprovtojë Britaninë e Madhe sa ishte e gatshme përnjëmend të hynte në luftë në anën e Perandorisë Osmane, Rusia në korrik të atij viti urdhëroi ushtrinë të kalonte lumin Prut dhe të pushtonte Principatat Danubiane. Perandoria Osmane reagoi dhe, me kërcënimin e luftës, kërkoi tërheqjen e menjëhershme të trupave ruse prej andej. Hezitimi i Britanisë së Madhe që Rusisë t’i dërgohej një notë me të cilën kërkohej tërheqja e saj, bëri që Rusia këtë ta kuptojë si lëkundje të Britanikëve, andaj cari urdhëroi admiralin rus të Detit të Zi të sulmonte flotën Osmane të ankoruar në Sinopë, duke e shkatërruar atë. Ky lajm i tronditi Londrën dhe bëri që “luani anglez” të dalë nga kafazi dhe me të drejtë, sepse me shkatërrimin e fuqisë detare të Osmanëve, Rusët mund të arrinin shpejt në Bosfor dhe nuk kishte më kohë për të tjerat.<sup>993</sup>

Kështu, Britania e Madhe me të shpejt u fut në luftë me Rusinë, e cila në të vërtetë ishte një luftë për shkatërrimin, siç e kërkonte Rusia, ose ruajtjen e Perandorisë Osmane, së paku edhe për një kohë për të cilën do të pajtoheshin fuqitë europiane, siç e kërkonte Britania e Madhe. Edhe pse britanikët kishin bindjen se do të mbështeteshin nga Austria dhe Prusia, të cilat po ashtu kishin interesat e veta, që Perandoria Osmane të mbahej për aq sa duhej, por assesit të mos rrënohej në përputhje me planet e Rusisë e aq më pak nëpërmes forcës së saj, megjithatë, këto vende, ndoqën një politikë të mosndërrhyrjes, ndërkohë që asaj iu bashkua Franca, pasi që Napoloni III kishte arsye për hakmarrje ndaj rusëve, por njëherësh shihnin një rast të mirë që bashkë me britanikët të shfaqeshin si mbikëqyrës të ujërave detare të Mesdheut dhe të rrugëve që çonin nëpërmes Egjiptit për në Indi e tutje.

---

<sup>993</sup> Po aty, faqe 294.

Kjo luftë, në të cilën Britania e Madhe dhe Franca hynë në anën e Perandorisë Osmane kundër Ruisë, njihet si Lufta e Krimesë, pasi që lidhet me sulmin aleat mbi gadishullin e Krimesë, në pjesën jugore të bregdetit rus në Detin e Zi.

Edhe pse kjo luftë zgjati më shumë se një vit dhe forcat britanike dhe franceze zbarkuan në Krime për të marrë Sevastopolin në mënyrë që prej andej t'i jepej një mësim i mirë Ruisë, që të përmbahet nga interesat europiane në këtë pjesë, pra që Perandorinë Osmane të mos e konsiderojë plaçkë të saj, dhe me gjithë marrjen e Sevastopolit në mars të vitit 1855 nga forcat aleate, por si gërmadhë, Rusia ushtarakisht nuk do të rrënohej (ngaqë kjo nuk ishte as në interesin e fituesve), por do të arrihej qëllimi politik, që Rusia të pranojë përfundimin e luftës dhe t'i nënshtrohet një marrëveshjeje paqësore. Me këtë rast u arrit pëlqimi për mbajtjen e një kongresi të paqes në Paris, në mars të vitit 1856. Në këtë kongres morën pjesë edhe Austria dhe Prusia.

Kongresin e Parisit e udhëhoqi Britania e Madhe, e cila ishte fituese e luftës dhe ishte në gjendje që të diktonte kushte. Ndër këto, më të rëndësishmet ishin ato që Ruisë e zhvishnin nga ambiciet e saj që të vendoste për fatin e Perandorisë Osmane dhe pjesës së Lindjes. Kështu, u vendos që ajo të humbte përfitimet kundrejt Perandorisë Osmane që kishe pasur në paqen e Kutçuk-Kainarxhit të vitit 1774. Po ashtu, traktati e detyroi carin që të hiqte dorë nga të gjitha pretendimet e tij për të mbrojtur Grekët e krishterë që jetonin në territorin e sulltanit. Rusia humbte edhe të drejtën për mbrojtjen e Serbisë dhe të principatave rumune të Moldavisë dhe Vllahisë. Së fundit, Ruisë iu ndalua lundrimi në Danub me dorëzimin e Besarabisë në duart e Moldavisë e cila ishte pjesë e Ruisë që prej vitit 1812 dhe pastaj të dorëzonte deltën e Danubit në duart e Perandorisë Osmane. Me këtë masë, lundrimi në Danubin e poshtëm nuk iu lejua Perandorisë Osmane, por u vendos nën mbikëqyrjen ndërkombëtare.

Por, fitorja më madhe e Britanisë kishte të bënte me atë që Ruisë t'i merrej e drejta ta mbikëqyrte lundrimin në Detin e Zi. Asaj, madje, iu ndalua që të kishte anije luftarake, arsenale dhe baza detare brenda këtyre ujërave.

Nga Paqja e Parisit, pati përfitime të rëndësishme edhe Perandoria Osmane, e cila si aleate e fitimtarëve duhej të trajtohej me respekt, me ç'rast, pasi që iu siguroi integriteti territorial, u pranua edhe në radhët e fuqive të mëdha europiane. Britanikët kishin arsye ta bënin këtë, pasi që sulltani, paraprakisht në shkurt të vitit 1856, përpara fillimit të punimeve të kongresit të Parisit, u kishte dhënë të drejta të reja shtetasve të tij. Sipas këtyre të drejtave që përfshiheshin në Tanzimatit e vitit 1839, regjimi i rajave rrëzohej dhe për pasojë myslimanët dhe të krishterët barazo-



heshin para ligjit dhe po ashtu, popullsia e krishterë e Perandorisë do të ishte tani nën mbikëqyrjen e vetë sulltanit.<sup>994</sup>

Rusia e cila mori një grusht të rëndë në Paqen e Parisit, në tjetrën anë, fitoi një mundësi që europianëve t'u hakmerrej për disfatën që ia sollën në Krime, ku marrja e të drejtës për t'u përkujdesur për Serbinë u dogji së tepërmi, meqë ata humbnin mbështetësin me anën e të cilit mund të pengohej zgjerimi i ndikimit rus në Ballkan në përputhje me ëndrrat hegjemoniste për të dalë në Adriatik. Kështu, me shpalljen e dekretit perandorak "*Hati-i Humayun*" kur të krishterët u barazuan para ligjit, kur raja nuk ekzistonte më si kategori shoqërore e diskriminuar dhe Perandoria Osmane ndodhej në rrugë që të kthehej në një monarki kushtetuese europiane, ajo këtë e shfrytëzoi, që në emër të kësaj të drejte të nxiste shtetet sllave të Ballkanit (Serbinë dhe Bullgarin, që të luftonin për t'u shkëputur nga Perandoria Osmane). Ndërkohë popujt sllavë në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në vilajetet shqiptare, ku ata ishin në pakicë, arriti t'i instrumentalizonte për ta çrregulluar stabilitetin e Perandorisë Osmane duke provokuar kështu gjendje të acaruar për të dëshmuar se fjala përnjëmend ishte për "një të sëmurë në Bosfor", që nuk e kishte të gjatë.

Në planin europian, për t'u liruar nga vijat që ia kishte krijuar Paqja e Parisit, Ruisë ia krijoi mundësitë lufta gjermano-franceze e vitit 1870 kur pas fitores së saj nga Gjermanët, pas një viti do të krijohet shteti i bashkuar gjerman, një fuqi tjetër europiane. Sepse, krijimi i Gjermanisë me të shpejtë ndryshoi pamjen e fuqive të mëdha europiane e bashkë me të edhe raportin e forcave, ku Britania e Madhe, pasi që humbi aleatin e saj kryesor Francën që u mund nga Gjermanët, mbeti e vetmuar, meqë Austro-Hungaria dhe më vonë Italia, iu bashkuan boshtit që pas pak do ta drejtojë Gjermania si fuqi e re.

Në këto rrethana ndodhi afria gjithnjë e më e madhe austro-ruse, perandori këto që ishin të përcaktuara që të mbikëqyrnin procesin e shthurjes së Perandorisë Osmane në pjesën europiane duke ia diktuar asaj jo vetëm dinamikën, por edhe interesat e tyre të drejtpërdrejta. Rusia, në këtë drejtim, pas luftës pruse-franceze dhe krijimit të Gjermanisë, duke mos u ndjerë më e detyruar ndaj vendimeve të Paqes së Parisit, që sipas saj kjo luftë i kishte nxjerrë nga fuqia, kishte filluar të nxiste Sllavët e Ballkanit, në radhë të parë Serbinë, që të kërkonte pavarësinë nga Porta, ndërkohë që nxiste edhe Sllavët në pjesët tjera, t'i bashkohen lëvizjes pansllave në Ballkan, e cila bëhej mbi baza të ortodoksisë. Kështu, Rusia, kishte në dorë

---

<sup>994</sup> Po aty, faqe 296.

dy atu që mund t'i përdorte për qëllime politike: ortodoksinë me gjithë infrastrukturën e saj kishtare në kryeqytetin osman (Fanariotët) dhe pansllavizmin.

Mbi këto karta, gjithnjë duke shfrytëzuar atmosferën e tendosur në pjesët europiane që kishte shpërthyer te shtresa konservative osmane, që nuk pranonte Tanzimatit ngaqë humbte pushtetin, në korrik të vitit 1875, filloi edhe kryengritja e popullsisë së krishterë në Hercegovinë, e cila me të shpejtë u përhap në Bosnje. Në këtë kryengritje, e cila u ndihmua me të madhe nga Serbia dhe Mali i Zi, morën pjesë vetëm Sllavët e krishterë, të cilët kërkesat sociale, me të shpejtë i ngjyrosen me ato nacionale.<sup>995</sup>

Këtu nduk duhet harruar se kësaj kryengritje, që me të shpejtë u instrumentalizua nga Rusët, po edhe Vjena, i parapriu revolta e elitës myslimane boshnjake në Sarajevë, Travnik dhe pjesët tjera të Bosnjës dhe Hercegovinës e drejtuar nga bejlerët, në krye të të cilëve ndodheshin Mahmut Pashë Tuzlla dhe Hafiz Pasha, kundër reformave të Tanzimatit, me të cilat ajo humbte shumë nga privilegjet, e mbi të gjitha qeverisjen autonome, që kishte gëzuar gjatë dy shekujve të fundit. Si dihet kjo kryengritje u shua në saje të fushatës së madhe ushtarake të Portës të drejtuar nga Omer Pasha Latasi, që kishte prejardhje sllave, i njohur edhe për shtypjen e kryengritjeve të shqiptarëve gjatë viteve 1844-1847 në kazanë e Shkupit (të drejtuar nga Dërvish Cara) dhe ato të Prishtinës dhe të Shkodrës. Ai, pasi që e shkretoi Bosnjën, me organizimin e administratës, rrënoi çdo pririje autonomiste të bejlerëve boshnjakë në këto anë, por njëherësh la një qeverisje bashibozuke, me ç'rast raportet e deritanishme u zëvendësuan me një dhunë dhe anarki të koçobashëve të rinj vendorë, që njësoj ishin të dëmshëm ndaj myslimanëve dhe të krishterëve, gjë që kjo periudhë e keq-qeverisjes në Bosnje, kur vendin e bejlerëve e zunë bashibozukët e shfrenuar, përgatiti terrenin për kryengritjet që pësuan njëzet vjet më vonë.<sup>996</sup>

Edhe pse kryengritja u shua nga ndërhyrja e forcave osmane, ajo la fitilin e saj të ndezur, të cilin Rusia e ushqente vazhdimisht me zjarr, gjë që pas një viti u gjallërua prapë, ndërsa në Bullgari po atë vit shpërthyen kryengritjet çlirimtare, të cilat u shtypen nga Porta.

Shtypja e kryengritjes së Hercegovinës dhe e Bosnjës, nxiti reagimin e dirigjuar të Rusisë te aleatët e saj në Ballkan për ta shfrytëzuar atë për t'u shkëputur

<sup>995</sup>Shih:Šišić, Ferdo: "Bosna i Hercegovina za vreme vezirovanje Omer-Paše Latase", Beograd 1938, faqe 38; Muradbegović, Ahmed: „Omer Paša Latas u Bosni, 1850-1852“, Zagreb 1944, faqe 66; Glenny, Misha: "Histori e Ballkanit 1804-1999", Tiranë , faqe 73-87; Castellán, Georges: "Histori e Ballkanit", Tiranë 1991, faqe 336-340.

<sup>996</sup> Glenny, Misha: "Histori e Ballkanit 1804-1999", Tiranë, faqe 73-78.

nga Perandoria Osmane. Kështu, Mali i Zi dhe Serbia kaluan në luftë të hapur antiosmane. Serbia më 30 qershor dhe Mali i Zi më 1 korrik 1876 i shpallën luftë Perandorisë Osmane. Rusia me këtë rast, krahas përkrahjes ndërkombëtare, “vëllë-zërve sllavo-ortodoksë” u dërgoi edhe mijëra vullnetarë rusë bashkë, të shumtën ushtarakë, me armë të shumta, të cilët u përfshinë në luftë kundër Turqisë.

Lufta kundër Perandorisë Osmane me anën e satelitëve të saj (Serbëve, Malaziasve, Bullgarëve) zuri të përcillej edhe me projektet e fshehta të Austro-Hungarisë dhe Ruisë për të rregulluar, sipas interesave të veta, hartën politike të Europës Juglindore. Pak ditë pas luftës midis Serbisë dhe Malit të Zi kundër Perandorisë Osmane, më 8 korrik 1876, Austro-Hungaria dhe Rusia, me anën e notave të veçuara bënë një marrëveshje në Rajhshtat (Reichstadt) të Bohemisë për ta rregulluar Gadishullin Ballkanik sipas interesave të tyre. Këto fuqi vendosen që të mos ndërhyjnë ushtarakisht në konfliktin e Serbisë dhe të Malit të Zi me Perandorinë Osmane. Por të dyja palët ranë në ujdë që, po ta fitonte luftën Perandoria Osmane, nuk do të bëhej asnjë ndryshim në hartën politike të Gadishullit Ballkanik. Megjithatë, me këtë rast do ta detyronin Portën e Lartë të zbatonte në dobi të popullsisë sllave disa reforma. Ndërsa po ta fitonte luftën pala tjetër (Serbia e Mali i Zi), Bosnja do të kalonte kryesisht te Austro-Hungaria dhe pjesërisht te Serbia, e cila do të merrte një pjesë të Kosovës (veriun e saj), kurse Mali i Zi një pjesë të Hercegovinës. Bullgaria do të bëhej shtet autonom dhe Rumelia një vilajet autonom. Vlen të thuhet se Vjena, nën presionin e vazhdueshëm që kishte prej Gjermanisë, që të mos lejohej krijimi i një shteti të madh sllav në Ballkan, u deklarua se Serbia nuk duhej të shtrihej deri në Adriatik, as Bullgaria nuk duhej të përfshinte Maqedoninë, sepse si njëra, si tjetra rrezikonin interesat austro-gjermane drejt Egjeut.<sup>997</sup>

Nota Austro-Hungareze prekte edhe çështjen shqiptare. Aty parashihej krijimi i një shteti autonom shqiptar. Pra, mund të thuhet se në Rajhshtat çështja shqiptare hyri për herë të parë në qerthullin e diplomacisë europiane si çështje politike nën mbikëqyrjen vjeneze.<sup>998</sup>

Si dihet kjo marrëveshje u plotësua edhe me një marrëveshje tjetër të fshehtë që këto vende lidhën në Budapest më 15 maj të vitit 1877, e cila mbështetej mbi platformën që ishte miratuar gjashtë muaj më parë në Rajhshtat dhe u plotësua me marrëveshjen shtojcë që u nënshkruar më 18 qershor 1877, sipas së cilës Austro-Hungaria do të qëndronte asnjëherë në luftën ruse-turke dhe për shpërblim do të

<sup>997</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 134.

<sup>998</sup> Po aty, faqe 134.

fitonte të drejtën të pushtonte ushtarakisht Bosnjën dhe Hercegovinën. Në këtë marrëveshje në parim pranohej ideja e një shteti autonom shqiptar, gjë që neutralizonte modelet e autonomive lokale “të krishtera” siç ishte ajo që do të shpallej më vonë nga Preng Bibë Doda i Mirditës, i cili, nën “flamurin e saj” do të hyjë në luftë kundër Perandorisë Osmane në anën e Rosisë.

Lufta e Serbisë dhe e Malit të Zi kundër Perandorisë Osmane, që filloi, e nisur dhe e mbështetur fund e krye nga Rusia e interesuar që me anën e pinjollëve të saj të sigurote rikthimin e atyre që kishte humbur në Krime, jo vetëm që nuk po fitohej, por Serbët, pas pushtimeve që i bënë viseve të Prokupës dhe të Kurshumlisë, u gjenden buzë një katastrofe të vërtetë. Ushtria Osmane, në rrugë e sipër të marshonte për në Beograd, u ndalua nga ana e një ultimatumit që Portës së Lartë i erdhi nga Rusia, më 1 nëntor, me anën e të cilit Perandoria kërcënohej me luftë po qe se nuk ndalte marshimin kundër Serbisë. Kështu, Serbia edhe si humbëse e luftës, pas katër muaj bisedimesh në Stamboll, me arritjen e paqes me sulltanin, doli e paprekur nga kjo luftë.<sup>999</sup>

Edhe përkundër kësaj, kjo luftë, edhe pse e humbur, nga një pikëpamje mund të quhej e suksesshme për Serbinë. Sepse, gjatë depërtimeve të para nga Nishi drejt Prokupës dhe Kurshumlisë, ushtria serbe ishte futur në pjesët e banuara me Shqiptarë dhe aty kishte bërë një masakër të madhe ndaj popullsisë së pambrojtur, një pjesë e së cilës ishte drejtuar për në Kosovë e vise të tjetra, e për t’i shpëtuar golgotës, duke u nisur drejt pjesës osmane.<sup>1000</sup>

Me këtë rast, nga këto pjesë u shpërngulën mbi 100 mijë banorë myslimanë, kryesisht shqiptarë nga 400 vendbanime, gjë që pranohet edhe nga burimet serbe, ndonëse ky gjenocid i atribuohet “luftës çlirimtare nga Perandoria Osmane”.<sup>1001</sup> Ndërsa shqiptarët e dëbuar do të shihen “si pushtues të Serbisë së Vjetër” pasi që të kenë pranuar islam. <sup>1002</sup>

Me këtë Serbia kishte krijuar rrethanat për pushtimet që do t’ua bëjë këtyre vise pas një viti, me rastin e luftës ruse-osmane.

---

<sup>999</sup> Shih: Sumner, B. H: “*Russia and the Balkans 1870-1880*”, Oxford, 1937, faqe 177.

<sup>1000</sup> Më gjerësisht rreth ngjarjeve 1877-1878 si dhe depërtimit të ushtrisë serbe në pjesën e Nishit e deri në Kurshuml, shih: Dimitrije – Mita Petrović: “*Bitka u Toplici 1877-1878*”, Jagodić, Miloš: „*Naseljavanje Kneževine Srbije 1861-1880*“, Beograd, 2004; “*Historia e Popullit Shqiptar*” II, Tiranë 2002, faqe 136-138; Buxhovi, Jusuf: “*Kongresi i Berlinit dhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878*”, Prishtinë 2012, faqe 25-28.

<sup>1001</sup>J. Cvijić: “*Osnove za geografiju i geologiju Makedonije i Stare Srbije*”, 1906; Василевич, J.Х.: „*Јужна Страна Србија*“, I, f. 483.

<sup>1002</sup>Djordjeviq Vladan: “*Die Albanensen und die Grossmächte*“, Leipzig, 1913.



## KAPITULLI I PESTË

### KRIZA LINDORE

#### LUFTA RUSO-OSMANE, SHËN STEFANI DHE REAGIMET E FUQIVE TË MËDHA

Lufta ruse-osmane filloi atëherë kur dukej se ajo ishte e panevojshme fare pasi që Perandoria Osmane, gjatë Konferencës së Kostandinopojë në dhjetor të vitit 1876, kishte shpallur dekretin e një kushtetute të re të sulltanit, e cila u jepte fund abuzimeve dhe njëherësh kështu ia hapte jetën parlamentarizmit osman, që do të kurorëzohet pas pak me zgjedhjet e para parlamentare të atij vendi, ku një e treta e deputetëve do të jenë të krishterë. Ndërsa aty do të ketë edhe Shqiptarë (Abdyl Frashërin, Mehmet Ali Vrionin e të tjerë), të zgjedhur mbi baza të përfaqësimit rajonal dhe jo të kombësisë, siç e kishin të krishterët.

Sidoqoftë, Perandoria Osmane kishte dhënë dëshmitë të drejtpërdrejta se kishite filluar kursin e reformave rrënjësore si monarki kushtetuese, pikërisht siç kishin kërkuar prej saj prej kohësh fuqitë e mëdha evropiane, ndonëse ndryshimet nuk mund të ishin aq të shpejta siç kërkohej. Por, për Rusinë, kjo nuk mjaftonte. Andaj, po atë vit, në Londër, u nënshkrua një protokoll me të cilin fuqitë e mëdha njohën parimin për kombësitë e Perandorisë Osmane dhe autonomitë e tyre, të cilat, në njëfarë mënyre duhej të mbikëqyreshin prej tyre. Aty u përmendën popujt që fitonin të drejtën e autonomisë (të krishterët), por Shqiptarët nuk u përmenden, edhe pse në atë ndërkohë kishte pasur një pretendim për diçka të tillë nga e ashtuquajtura Krahinë Autonome e Mirditës, që e kishte shpallur Preng Bibë Doda, gjatë luftës së Malit të Zi me Perandorinë Osmane dhe Serbinë. I shtyrë nga Rusët dhe i përkrahur nga Malaziasit, bajraktari i Mirditës, ngriti në Orosh flamurin e luftës për autonominë e Mirditës.

Në të vërtetë, duke u mbështetur mbi të drejtën që popujve të krishterë u ishte dhënë që të krijonin autonomitë e tyre në pjesën evropiane të Perandorisë Osmane dhe se për këtë ata do të mbështeteshin nga fuqitë e mëdha, kapedani i saj, Preng Bibë Doda, i biri i Dodë Pashës, i cili qysh nga vdekja e të atit (1868), ende i ri,

mbahej në i internuar në Stamboll me pretext se vazhdonte shkollimin, gjatë disa takimeve që kishte pasur me ambasadorët e Ruisë, të Francës dhe të Austro-Hungarisë, kishte shfaqur kërkesën për t'u bërë princ i një Mirdite autonome.<sup>1003</sup>

Edhe pse Parisi dhe Vjena, nuk e kishin përkrahur këtë ide, meqë sipas Austro-Hungarisë ajo ngushtonte çështjen shqiptare jashtë synimeve që kjo kishte për një Shqipëri etnike, pra me tërësinë e saj jashtë vijave të brendshme fetare, natyrisht në përputhje me interesat e veta, që ajo duhet të paraqiste një digë kundër pansllavizmit në Ballkan, Rusia përkrahu atë, me kusht që Preng Bibë Doda të lidhte aleancë ushtarake me Cetinën dhe të sulmonte me mirditorët ushtritë osmane, që ishin të zëna me luftë në kufirin malazez.<sup>1004</sup>

Ky veprim nuk ishte pritur mirë nga pjesa tjetër e Shqiptarëve, të cilët e dinin se ku mund të shpinte e gjitha, çështje kjo, që si do të shihet, do të merrte parasysh edhe nga fuqitë e mëdha europiane, me përjashtim të Ruisë, të cilat nuk kishin lejuar që në Traktatin e Londrës të zihet ngojë autonomia e Mirditës. Edhe pse në pakon e Londrës Shqiptarët u përjashtuan nga parimi i të drejtës së autonomisë me arsyetimin se ende nuk ishin pranuar si komb i veçantë, meqë Perandoria Osmane edhe më tutje i trajtonte në kuadër të milletit-osman, prapë se prapë, me marrëveshjen e Budapestit, u shënua akti i parë diplomatik ndërkombëtar që pranoi idenë e krijimit të një shteti shqiptar jashtë koncepteve të feudeve autonome siç ishte ai i Mirditës, që u përmend edhe në Kongresin e Berlinit, por do të hedhet poshtë nga Austro-Hungaria dhe Britania e Madhe me të njëjtat motive.<sup>1005</sup>

Pavarësisht këtyre zhvillimeve, pakoja osmane e Londrës, me kushtetutën ose pa të, pos të tjerash, parashihte mbikëqyrjen e plotë të europianëve ndaj reformave, me çka atë e vinte në nën kontrollin e fuqive të mëdha europiane. Sulltani, pranoi programin, por jo humbjen e pavarësisë së tij nga ndërhyrja e fuqive të mëdha.

Kjo i dha “shkas” Ruisë, e cila ishte më e interesuara për një konflikt të Perandorisë Osmane me fuqitë e mëdha europiane dhe punonte pareshtur nga brenda (me anën e përdorimit të vazhdueshëm të sllavo-ortodoksëve) që ajo të dështonte, që të hynte në luftë. Më 24 prill 1877 ajo i shpalli luftë Perandorisë Osmane.<sup>1006</sup>

Fillimisht lufta ruse-osmane nuk u tregua se po u shkonte përshtati sulmuesve, meqë forcat ruse, jo vetëm që nuk po mund ta merrnin Plevnën, por ato zunë të pësojnë humbje të tjera në shumë pjesë nga ushtria osmane që komandohej nga gjene-

---

<sup>1003</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 136.

<sup>1004</sup> Po aty, faqe 136.

<sup>1005</sup> Më gjerësisht shih: Buxhovi, Jusuf: “*Kongresi i Berlinit 1878*”, Prishtinë, 2008, faqe 143-149.

<sup>1006</sup> Sumner, B.H: “*Russia and the Balkans*”, 1870-1880”, Oxford, 1937, faqe 177.

rali Osman Pasha. Që të mos humbej lufta, Rusëve u erdh në ndihmë ushtria rumune, e princit Karl, i cili u vu në krye të ushtrisë ruse-rumune. Pas disa muajsh luftimesh, në dhjetor, trupat osmane në Plevne kapitulluan, ndonëse kjo nuk parashihej nga vëzhguesit ushtarakë europianë. Doli se pas kësaj humbje, ushtria osmane sikur nuk ishte e interesuar të bënte kurrfarë rezistence tjetër. Lejoi që trupat ruse dhe rumune të depërtonin lirshëm në pjesët strategjike, gjë që pasi kaluan nëpër malet Ballkane dhe morën Adrianopojën, në janar arritën deri në Marmara. Dukej se ky veprim kishte të bënte me atë që sulltani të provokonte një ndërhyrje ushtarake të fuqive perëndimore kundër Ruisë, të ngjashme me atë të luftës së Krimesë në vitin 1865. Meqë kjo nuk ndodhi, për ta parandaluar një katastrofë të plotë, sulltani vendosi të hynte në bisedime për paqe me Rusët në qytetën e Shën Stefanit.<sup>1007</sup>

Megjithatë, lufta ruse-osmane pati një ndikim të madh te popujt e krishterë të Ballkanit. Aleatët e Ruisë, të rreshtuar në anën e saj, me të drejtë prisnin që t'i gëzonin frytet e kësaj aleance.

Natyrisht se kjo luftë, me përjashtim të rastit të veçuar të kapëdanit të Mirditës dhe rreshtimit të tij në anën e rusëve, shqiptarët e krishterë dhe grekët, i ballafaqonte me sfidën që nëse i bashkoheshin asaj të futeshin nën sferën e ndikimit rus dhe të konceptit hegjemon sllavo-ortodoks, gjë që i përjashtonte nga ajo evropiane. Ndërsa, po të përcaktoheshin për mbrojtjen e territoreve të tyre nga pushtimet sllavo-ortodokse, siç kërkoheshin nga pjesa më e madhe e shqiptarëve të besimit islam, i kthente në “mbrojtës” të Perandorisë Osmane, me çka ata, në rast humbjeje, i kthente si pre në duart e fitimtarëve.

Kjo dilemë për Shqiptarët ortodoksë dhe për Grekët u bë edhe më e madhe çastin që Rusia, më 24 prill 1877, lëshoi një proklamantë, me të cilën cari rus ftonte të gjitha kombësitë e krishtera të Gadishullit Ballkanik të rrëmbenin armët krahas ushtrive ruse, pasi për ta, si thuhej, tashmë kishte ardhur dita e çlirimit nga shtypja osmane.<sup>1008</sup>

Meqë sehiri ngarkonte dyfish, te qarqet atdhetare shqiptare kishte filluar të fitonte në peshë ideja e një kryengritjeje çlirimtare, ngaqë Perandoria Osmane nuk ishte në gjendje që të mbronte territoret shqiptare nga pushtuesit sllavë. Kështu, në maj të vitit 1877, në Janinë formohet një Komitet Shqiptar, i cili duhej të vinte në jetë idenë e një kryengritjeje çlirimtare. Në kryet të tij ishte vu Abdyl Frashëri, i cili kishte qenë edhe deputet i Janinës në parlamentin e parë osman që ishte zgjedhur asokohe. Ky Komitet, edhe pse quhej shqiptar, kishte karakterin e një vilajeti,

<sup>1007</sup> Medlicott, W.M: “A diplomatic History of the Near Eastern Settlement, 1878-1880”, London, 1938, faqe 39.

<sup>1008</sup> Sumner, B.H: “Russia and the Balkans”, 1870-1880”, Oxford, 1937, faqe 177.



atij të Janinës, në të cilin ishin të përfshirë përfaqësuesit e të gjitha pjesëve të këtij vilajeti: Mehmet Ali Vrioni (Berat), Mustafa Nuri Vlora (Vlorë), Sulejman Tahiri (Tepelenë), Vesel Dino (Prevezë) e të tjerë dhe nuk ishte jashtë dyshimit të arsyeshëm se nuk ishte edhe jashtë interesit të Perandorisë Osmane, e cila ishte e interesuar që të mobilizonte faktorin shqiptar në kufi me Greqinë për luftë kundër Rosisë dhe aleatëve të saj sllavë (Serbëve dhe Malaziasve), të cilët tashmë ishin deklaruar edhe kundër Greqëve, të cilët cari i Rosisë i kishte zëvendësuar haptas me faktorin sllavo-ortodoks, veçmas me atë bullgar.

Se fjala ishte për një bashkëveprim për t'u mbrojtur nga pushtimet sllavose-ortodokse në këto pjesë, të cilat njësoj kërcënonin interesat e Shqiptarëve dhe Greqëve, që do t'i shkonte përshtati edhe Perandorisë Osmane, e cila kështu mund ta gëzonte përkrahjen e fuqive evropiane antiruse, këtë do ta thotë edhe Abdyl Frashëri. Disa muaj më vonë shkruante se “Europa do të bindej se qytetërimin e saj në Gadishullin Ballkanik mund ta mbronte nga rreziku rus vetëm diga greke, por së bashku me të, edhe diga shqiptare”.<sup>1009</sup>

Si do të shihet pas pak, kjo do të jetë një lajthitje jo vetëm e Abdylit dhe e Komitetit të Janinës, por edhe atyre qarqeve perandorake osmane, të cilat mendonin se një aleancë shqiptaro-greke me frymë osmane do t'i ndihmonte parandalimit të asaj që do të shfaqet pak më vonë në Paqen e Shën Stefanit.

Në të vërtetë, asokohe, aleancën e Shqiptarëve dhe Greqëve e kërkonin edhe qarqet nacionaliste heleniste, të cilat ishin të frikësuara së tepërmi se Rusia, e interesuar për Bullgarinë e Madhe do të mund të përfshinin Trakinë dhe Maqedoninë në kufijtë e saj të ardhshëm. Andaj, një Greqi me një milion banorë, e cila nuk ishte në gjendje për kurrfarë veprimi luftarak, e pa të udhës që këtë ta bënte me përfshirjen e Shqiptarëve në luftë, gjë që propozimi i Komitetit të Janinës për një aleancë shqiptaro-greke gjeti një pritje pozitive në qarqet qeveritare të Athinës. Qeveria greke pranoi të hynte në bisedime me Shqiptarët.<sup>1010</sup>

Bisedimet u zhvilluan në mënyrë të “fshehtë”<sup>1011</sup> në Janinë gjatë gjysmës së dytë të korrikut 1877 ndërmjet Abdyl Frashërit, i cili shoqërohej nga Mehmet Ali Vrioni dhe Epaminonda Mavromatis, funksionar i Ministrisë së Jashtme greke.<sup>1012</sup>

---

<sup>1009</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 140.

<sup>1010</sup> Po aty, faqe 141.

<sup>1011</sup> Dokumentet e Arkivit Politik të Ministrisë së Jashtme Gjermane bëjnë të ditur se për këto bisedime kishte njohuri Perandoria Osmane, e cila shtrej se nuk dinte gjë, por që më parë Abdyl Frashëri kishte pasur konsultime me zyrtarë të lartë osmanë rreth “frontit të rezistencës kundër Rosisë”. (Depesha e ambasadës gjermane në Stamboll, nr. 38/48, datë 2 gusht 1877, të arkivuar në kutinë: Türkei, 143.)

<sup>1012</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 141.

Qysh në fillim u pa se takimi do të dështojë, ngaqë pikëpamjet ishin fare të ndryshme, meqë Abdyl Frashëri, pasi që parashtrroi interesat e përbashkëta që më shumë ishin të natyrës kundër pushtimeve pansllaviste, kërkoi që midis palëve të lidhej paraprakisht një aleancë ushtarake, e cila për kusht që Shqiptarët të ngriheshin në një kryengritje kundër Perandorisë Osmane, ku do të shpallej pavarësia e Shqipërisë, nënkuptonte që Athina t'i shpallte luftë Perandorisë Osmane dhe ta njihte principatën e pavarur shqiptare, e cila do të ishte në përputhje me kufijtë etnikë të Shqipërisë, duke përfshirë Kosovën në veri, deri në Vranje, dhe Çamërinë në jug, deri në Prevezë. Shqiptarët, si kundërshtpërblim për këtë, do t'i ndihmonin ushtrisë greke që pa ndonjë vështirësi të pushtonte Thesalinë dhe Maqedoninë, meqë atje shumica e oficerëve që shërbenin në garnizonet osmane ishin Shqiptarë dhe me urdhër të Komitetit të Janinës do t'i dorëzonin pa luftë qytetet.<sup>1013</sup>

Edhe pse në asnjë burim meritor të kohës, së paku nga ato të diplomatëve gjermanë, austriakë, osmanë e as ato ruse të mirinformuara nga Stambolli ose Athina, nuk përmendet kërkesa për shpallen e “provincës shqiptare”, që do të njihej nga Athina, megjithatë, burimet gjermane dhe ato austriake nga Stambolli nga ky takim nxjerrin kërkesat e palës greke të cilat janë: pjesëmarrja e gjerë e Shqiptarëve në luftë kundër forcave osmane, të cilave do t'u ofrohet ndihmë nga “vullnetarët epirotë” si dhe mundësia që Greqia të shqyrtojë pozitivisht kërkesën që kryengritja të kishte karakterin shqiptar vetëm përtej lumit Seman, por me kusht që edhe këto vise të kërkonin bashkimin e tyre me Greqinë për të formuar një krahinë shqiptare nën sovranitetin e mbretit të Greqisë.<sup>1014</sup>

Këto burime, megjithatë bëjnë të ditur se Athina, pasi t'ua ketë matur pulsën Shqiptarëve të Jugut, të cilët kërkonin mbrojtjen e territoreve të tyre në përputhje me interesat e tyre, që silleshin kah një autonomi shqiptare brenda shtrirjes etnike që kishin dhe në përbërje të Perandorisë Osmane, do të krijojë të ashtuquajturin “Komitet të Epirit” në Korfuz nga emigrantë dhe mercenarë, e ku kishte dhe disa Shqiptarët të besimit ortodoksë, të cilët kërkonin bashkimin e Vilajetit të Janinës me Mbretërinë Greke. “Komiteti i Epirit”, kryekreje i mbikëqyrur nga Athina, filloi të vepronte nga fillimi i gushtit të atij viti drejt organizimit të një kryengritje gjoja shqiptare, por me qëllime filogreke.<sup>1015</sup>

---

<sup>1013</sup> Po aty, faqe 142.

<sup>1014</sup> Dokumentet e APMJGJ (Arkivi Politik i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Gjermanisë në Bon), Türkei, kutia 143, dok. nr. 137-41.

<sup>1015</sup> Po aty, dok 147/43,44.

Veprimtaria e “*Komitetit të Epirit*”, zhvlerësoi në tërësi punën e Komitetit të Janinës, por nuk i ndali kontaktet e mëtutjeshme të Shqiptarëve me Grekët rreth aleancave të mundshme. Disa takime të ngjashme u mbajtën në Stamboll, në nivel “të parlamentarëve” të dy vendeve, Abdyl Frashërit i zgjedhur deputet në zgjedhjet e vjeshtës së vitit 1877 dhe Stefanos Skuludhos, deputet në parlamentin Grek. Abdyl Frashëri si parlamentar, njëherësh përfaqësonte Komitetin e Stambollit me emrin “*Komitetit Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare*”, ose siç u quajt “*Komiteti i Stambollit*”, i themeluar në dhjetor të vitit 1877, kryetar i të cilit ishte Abdyl.<sup>1016</sup>

Edhe këto bisedime nuk sollën gjë, pos që u testua raporti i Shqiptarëve ndaj Greqisë dhe veprimet greke të njohura që ajo do të ndërmarrë pak më vonë kundër trojeve shqiptare.

Meqë në fillim të janarit të vitit 1878 në fushëbeteja gjendja u përmbys në dëm të Osmanëve dhe në dobi të rusëve dhe, e gjitha përfundoi me disfatën e Osmanëve, dhe kur këtë rënie ushtarake të forcave osmane, të cilat filluan të ikin në të gjitha drejtimet do ta shfrytëzojë ushtria serbe për të marshuar drejt vilajetit të Kosovës me ç’rast morën Pirotin, Nishin, Kurshumlinë, Prokupën dhe Vranjën dhe në fillim të janarit arritën në Gjilan, ndërkohë që ushtritë malazeze pushtuan në janar Tivarin dhe pas pak edhe Ulqinin dhe dolën edhe në brigjet e Liqenit të Shkodrës e të lumit Buna, pra kur po përmbusheshin shumë nga parashikimet ogurzeza rreth pushtimit të trojeve shqiptare nga aleatët e rusëve, të cilët gjendeshin pranë Stambollit, Komiteti i Stambollit, ndryshoi strategjinë. Planet për shpalljen e luftës çlirimtare i zëvendësoi me ato të mbrojtjes së territoreve shqiptare nga rrezikimi i copëtimit të mëtutjeshëm të Shqipërisë. Në këtë rast ata Perandorinë Osmane e shihnin si mbrojtëse dhe garantuese të vetme të qenies shqiptare, andaj u rreshtuan në anën e mbrojtjes së saj.

Këtë përcaktim e bëri edhe më të fuqishëm Paqja e Shën Stefanit, që u nënshkruar më tre mars 1878, prej nga doli Traktati i njohur i Paqes ndërmjet Perandorisë Osmane dhe i Perandorisë Ruse.

Traktati i Shën Stefanit i shkëputte Perandorisë Osmane rreth 80 për qind të territoreve të saj në Gadishullin Ballkanik. Synimet e saj hegjemoniste në Europën Juglindore Rusia cariste do t’i siguronte kryesisht nëpërmjet Bullgarisë së madhe autonome që u krijua me këtë traktat. Bullgaria shfaqej si principatë autonome me qeverinë e saj, tributare ndaj sulltanit. Në kufijtë e saj do të përfshihej shumica

---

<sup>1016</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 142.

dërmuese e tokave që i shkëpute Perandorisë Osmane. Kjo do të shtrihej në lindje deri në Detin e Zi, në jug deri në detin Egje, në veri deri në Danub dhe në perëndim deri në malet e Voskopojës. Pjesa tjetër e territoreve perandorake do t'i jepej Rumanisë, Serbisë dhe Malit të Zi, që ktheheshin nga principata autonome në shtete të pavarura.<sup>1017</sup>

Kështu, gati gjysma e trojeve shqiptare u jepej shteteve sllave ballkanike. Bullgaria përveç të tjerave, fitonte krahinat shqiptare të Korçës, të Blinishtit, të Pogradecit, të Strugës, të Dibërës, të Kërçovës, të Gostivarit, të Tetovës, të Shkupit, dhe të Kaçanikut. Serbia, e cila do të shtrihej kryesisht drejt jugperëndimit, do të aneksonte edhe viset veriore e verilindore të Kosovës, deri në afërsi të Mitrovicës. Mali i Zi, sipërfaqja e të cilit do të rritej më tepër si tri herë, do të përfshinte brenda kufijve të tij gjithashtu një varg krahinash shqiptare, si atë të Ulqinit, të Krajës, të Anamalit, të Hotit, të Grudës, të Tuzit, të Kelmendit, të Plavës e të Gucisë dhe të Rugovës.<sup>1018</sup>

## LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT

Paqja e Shën Stefanit dhe realitetet e krijuara prej saj, të cilat më së shumti qëllonin Shqiptarët dhe interesat e tyre shtruan nevojën për një veprim të përbashkët të të gjitha forcave shqiptare, pavarësisht bindjeve dhe qëndrimeve që kishin rreth të ardhmes së Perandorisë Osmane, në mënyrë që përfundimisht të faktorizoheshin si në raport ndaj Perandorisë Osmane dhe karshi faktorit ndërkombëtar të vendosjes. Në atë fatkeqësi për herë të parë Shqiptarët kishin përballë rrethana të dobishme për këtë veprim, meqë të pakënaqur me Shën Stefanin, krahas Osmanëve, ishin edhe fuqitë e mëdha europiane, pa përjashtim, të cilat ndonëse luftën ruse-osmane do ta shikojnë me mjaft indiferencë, me të shpejtë do t'i refuzojnë të arriturat e asaj bashkë me marrëveshjet dhe do të kërkojnë që ato të zhbëhen në tërësi.

Në këto rrethana, krahas hovit që mori lëvizja e protestës kundër Traktatit të Shën Stefanit, ishte edhe ideja për të kundërshtuar me armë vendimet që mund të merreshin në Kongresin e Berlinit në dëm të tërësisë tokësore të atdheut. Kështu, kërkesa për të formuar një lidhje të përgjithshme u bë mjaft popullore edhe për faktin se ajo ishte në përputhje edhe me qëndrimet e Perandorisë Osmane, e cila

---

<sup>1017</sup> Më gjerësisht rreth vendimeve të paqes së Shën Stefanit shih: Buxhovi, Jusuf: *"Kongresi i Berlinit 1878"*, Prishtinë, 2008, faqe, 95.

<sup>1018</sup> *"Historia e Popullit Shqiptar"* vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 148.

në këtë mënyrë ishte e interesuar që kongresin e ardhshëm europian, i cili do të mbahej në Berlin, ta shfrytëzonte sa më shumë për t'i riparuar dëmet e luftës dhe paqes me Rusët, por këtë herë me ndërhyrjen e Fuqive të Mëdha europiane, të cilat njëherësh, si kundërshtarë të Rusisë dhe planeve të saj, shfaqeshin edhe si mbrojtëse të saj. Kjo gjendje, pra, duhej shfrytëzuar me të gjitha mjetet dhe me të madhe. Andaj, çfarëdo proteste dhe çfarëdo programi, qoftë ai edhe luftarak me moton e mbrojtjes së vatanit, siç shfaqej ai i Shqiptarëve, me ç'rast kuptimi i "vatanit" mund të shikohej edhe i atdheut, pra i etnisë, siç ishte rasti me mbrojtjen e katër vilajeteve shqiptare, identifikoheshin me atë të përgjithshmin, gjë që kjo i shkonte për shtati Perandorisë Osmane. Për herë të parë nacionalizmi dhe osmanizmit shkonin bashkë, gjë që kjo ishte motivues.

Dihomia patriotike, megjithatë, nga brenda kishte disa filtra, nëpër të cilët përçoheshin kërkesa të ndryshme, të cilat, shikuar në planin politik, shpesh ishin edhe shpërputhëse me njëra tjetrën, sepse për shumë Shqiptarë mbrojtja e Perandorisë nënkuptonte mbrojtjen e tokave shqiptare nga copëtime e mëtutjeshme, siç nënkuptonte edhe mënyrën e përligjjes së tyre në një formë apo tjetër, që do të thoshte se i ashtuquajturit patriotizëm osman ose për shumë edhe islam, duhej të përfshinte edhe *patriotizmin atdhetar*, që sipas Sami Frashërit, nuk ishte tjetër pos shprehje e *identitetit kombëtar* edhe në rrethanat perandorake, i cili shfaqej edhe stimulues për atë të përbashkëtin (vatanin) po qe se ai ndërliqej me idenë e etnisë si autonomi brenda për brenda identitetit të përbashkët perandorak.<sup>1019</sup>

Në këto rrethana, qarqet e atdhetarëve shqiptarë, të përfaqësuar, në përgjithësi, nga Komiteti i Stambollit, i cili tashmë, nga ai për mbrojtjen e të drejtave të Shqiptarëve, kishte marrë edhe epitetin Kombëtar, të mbrojtjes kombëtare, mbi-sundonte rryma radikale, e cila synonte të themelonte një lidhje shqiptare, e cila duhej të mobilizonte popullsinë e vendit në emër të të drejtave kombëtare të Shqipërisë dhe të drejtonte atë në luftë për ruajtjen e tërësisë tokësore të atdheut, duke kërkuar në të njëjtën kohë krijimin e një vilajeti autonom shqiptar, ose po ta lejonin rrethanat ndërkombëtare, të një shteti shqiptar autonom,<sup>1020</sup> që mund të quhej edhe Shqipëri Osmane. Sipas ithtarëve të kësaj rryme lidhja shqiptare duhej përgatitur për të luftuar, në përshtatje me rrethanat që do të krijoheshin, jo vetëm kundër shteteve shoviniste fqinje, por edhe kundër Perandorisë Osmane.<sup>1021</sup>

---

<sup>1019</sup> Më gjerësisht rreth kësaj shih: Gawrych, George: "Gjysmëhëna dhe Shqipëria – Sundimi Otoma, Islamizmi dhe Shqiptarizmi", Tiranë, 2007, faqe 11-17

<sup>1020</sup> "Historia e Popullit Shqiptar", vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 150.

<sup>1021</sup> Po aty, faqe 150.

Krahas tyre ishte edhe një grupim tjetër ose rrymë e dytë në lëvizjen kombëtare, ajo e *të moderuarve*, si quheshin, që përfaqësoheshin nga personalitete të njohura atdhetare, si Ali bej Gucia, Ilijaz pashë Dibra, Abedin pashë Dinoja, Mahmud pashë Biçoku, Omer pashë Vrioni e të tjerë, të cilët, si edhe radikalët, kërkonin që lidhja të kishte karakter kombëtar. Ata e pranonin në parim idenë e vilajetit të bashkuar autonom shqiptar, të pajisur me një autonomi administrative dhe kulturore, por jo që ajo të paraqitej si hallkë për të shkuar te shteti shqiptar që mund të shkëputej. Ata nuk ishin të prirë që t'i kundërviheshin Portës së Lartë, meqë ata shpresonin se vilajeti shqiptar mund të krijohet me pëlqimin e sulltanit, të cilin, besonin se do ta bindnin, pasi, sipas tyre, krijimi i këtij vilajeti ishte në interes të vetë Perandorisë Osmane.<sup>1022</sup>

Midis radikalëve dhe të maturve, ishte edhe një rrymë tjetër, ajo e *sulltanistëve*, në të cilën bënin pjesë nëpunës dhe zyrtarë të lartë turkomanë të administratës së vilajeteve, nga elemente feudalë vendorë e kleri turkoman, të cilët identifikoheshin me qarqet sunduese perandorake, anonin plotësisht nga vija politike e Portës së Lartë dhe i shërbenin asaj. Të tillët do t'i bashkohen lëvizjes me direktivat e drejtpërdrejta të sulltanatit dhe kërkonin që lidhja e rezistencës të quhej *Lidhja islamike*.<sup>1023</sup>

Veç kësaj, *sulltanisët*, nuk e pranonin as në parim idenë e një vilajeti shqiptar, sepse ky vilajet, sipas tyre, do t'i ndante Shqiptarët myslimanë nga “vëllezërit” myslimanë të Gadishullit Ballkanik dhe të Perandorisë Osmane.<sup>1024</sup>

Ishte, pra fjala, për një rrymë e cila për ideator kishte pikërisht sulltan Hamidin dhe idenë e tij “bashkuese” për të gjithë myslimanët, e cila do të duhej të promovohet pikërisht në Ballkan dhe pikërisht te Shqiptarët, që sipas tij paraqisnin “lulen e islamit”<sup>1025</sup>, që si të tillë duhej të mbeteshin për t'ia ruajtur kalifatit rrënjën e vet në pjesën europiane, lëvizje kjo e cila do të mbetet e pranishme gjatë gjithë kohë dhe do të ndikojë që kjo frymë, së paku formalisht, të shfaqet edhe në *Kararnamenë* Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në pikën dy për të mbetur si e tillë edhe deri te katërmbëdhjetë pikat e njohura të Hasan Prishtinës të gushtit të vitit 1912.

Për t'u evituar përçarjet mbi këto baza, të cilat do të ishin të dëmshme, Komiteti i Stambollit, vendosi që përpjekjet për thirrjen e një lidhjeje shqiptare t'i

---

<sup>1022</sup> Po aty, faqe 150.

<sup>1023</sup> Po aty, faqe 151.

<sup>1024</sup> Po aty, faqe 151.

<sup>1025</sup> Më gjerësisht shih: Buxhovi, Jusuf: “*Nga Shqipëria Osmane te Shqipëria Europiane*”, Prishtinë, 2010.

bëjë nën moton e kundërshtimit të Traktatit të Shën Stefanit, duke u shprehur se ishte e gatshme që jetësimi i tij të ndalej edhe me anën e luftës që do të bëhej me moton e mbrojtjes së vatanit nga copëtimi, në të cilën do të merrnin pjesë që të gjitha rrymat pa dallim, gjë që ishte një e arritur e madhe në planin e brendshëm për herë të parë gjente gjuhë të përbashkët manifestimi i hapur i shqiptarizmit me osmanizmin si një vlerë e re që po dilte në pah dhe po fitonte legjitimitet shoqëror, politik dhe kulturor, që do të mbizotërojë raportet e ardhshme, të Shqiptarëve me Perandorinë Osmane për tridhjetë e katër vitet e ardhshme deri sa do të bjerë perdja e saj në Ballkan. Kjo njëherësh ishte edhe porosi që i shkante Kongresit të Berlinit, i cili duhej të mbahej së shpejti dhe ishte më se e qartë që për pikënisje do të kishte anulimin e Traktatit të Shën Stefanit. Në këtë frymë ishin edhe disa prononcime të liderëve të Komitetit të Stambollit në mediet europiane drejtuar opinionit european por edhe fuqive të mëdha, siç ishte ai i Abdyl Frashërit në *“Messager de Vienne”*. Frashëri argumentonte të drejtat politike që i takonin popullit shqiptar me arsyetimin se nuk kërkon tjetër veçse të jetojë i liri, të dalë nga prapambetja dhe të zërë vendin që meriton në radhët e kombeve të qytetëruara të Europës.

Meqë koha po afronte dhe duhej dalë me një formë organizative para se të fillonte Kongresi i Berlinit, në mënyrë që Fuqive të Mëdha Europiane t’u tregohet se çfarë kërkonin në të vërtetë Shqiptarët dhe cilat ishin pozicionet e tyre politike, Komiteti i Stambollit, në “fshehtësi të plotë”<sup>1026</sup> gjoja për të mos shkak-

---

<sup>1026</sup> Shumë historianë Shqiptarë, ndër ta edhe hartuesit e *“Historisë së popullit shqiptar”*, vëllimi i dytë, Tiranë 2002, faqe 153, vazhdimisht theksojnë se Lidhja u mbajt “në rrethana të fshehtësisë së plotë”, që “të mos nxiste reagimet e qeveritarëve osmane”. Ky qëndrim nuk është i argumentuar dhe jashtë logjikës së ngjarjeve. Sepse, Perandoria Osmane kishte shumë interes për një reagim të Shqiptarëve. Burimet e shumta, bëjnë të ditur se Perandoria Osmane kishte dërguar emisarë specialë në Vilajetin e Kosovës dhe të Shkodrës që të mbaheshin mitingje protestuese kundër Paqes së Shën Stefanit - në Prishtinë, Shkup, Shkodër dhe qyte të tjera. Valiu i Kosovës dhe ai i Shkodrës kishin mbajtur mbledhje të vazhdueshme me parinë e vendit dhe kishin bërë thirrje për krijimin e komiteteve të rezistencës, me ç’rast ishin regjistruar publikisht edhe vullnetarët që do të shkonin për t’u mbrojtur territoret shqiptare. Shtypi european, veçmas ai gjerman, shënon këto forma të manifestimit dhe i vë në lidhje me autoritet osmane, meqë në ato rrethana Shqiptarët dhe Portën e Lartë i lidhte i njëjti interes: mbrojtja e territoreve osmane nga copëtimet. Ka shumë autorë, ndër ta Roland, Bartl *“Die Albanische Muslime zur Zeit der nationalen Unabhenigkeitsbewegung 1878-1912”*, Wisbaden, 1968; Schanderl, Hans Diter: *“Die Albanienpolitik Österreich-Ungarns und Italien 1877-1902”*, 1950; Gopcevic, Spiridon: *“Oberalbanien und seine Liga”*, Leipzig, 1881; Ippen, Theodor: *“Beitrag zur innere Geschichte Albanien im XIX Jahrhundert”*, botuar te *“Illyrisch-Albanische Forschungen”*, band, 1, München-Leipzig, 1916; Stavri Skëndo *“Zgimi kombëtar shqiptar”*, Tiranë, 2002; George Gawrych *“Gjysmëhëna dhe shqiponja”*, Tiranë, 2007; Jozef von Hamer *“Istorija Otomanskog Carstva”*, Zagreb, 1968 e të tjerë, që vlerësojnë se Komiteti i Stambollit ishte në kontakte të vazhdueshme me Portën e Lartë rreth formës së organizimit të reagimit shqiptar dhe madje së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, mirëvajtja e të cilës jo vetëm që nuk ishte e “fshehtë” por manifestim i hapur, i cili, nga kleri mysliman, u propagua me të madhe gjatë gjithë kohës. Kjo atmosferë pasqyrohet edhe në shumë raporte të konsujve gjermanë, austriakë, francezë nga Shkodra,

tuar reagimin e hapur të organeve qeverisëse, mori vendimin për t'u thirrur Kuvendi i Lidhjes. Kjo nuk përkon me realitetin, sepse pikërisht ana demonstrative ishte ajo që u duhej edhe Shqiptarëve, edhe Perandorisë Osmane, por siç u cek më lartë, edhe fuqive të mëdha europiane pa dallim, të cilat ishin të interesuara, secila në mënyrën e vet që këtë ta shfrytëzonin për hesapet e veta. Kjo madsje dëshmohej më së miri edhe me interesimin e Portës së Lartë për një reagim të organizuar të Shqiptarëve kur në fund të majit, në Stamboll thirri personalitet më të dëgjua të jetës politike: Iliaz pashë Dibrenë, Ali bej Gucinë, Ymer Prizrenin, Ahmet Korenicën, Zija Prishtinën, Mustafa pashë Vlorën, sheh Mustafë Tetovën, Vejsel bej Dinon dhe disa dhjetë ra të tjerë, e ku merrte pjesë edhe Abdyl Frashëri, Mehmet Ali Vrioni, si përfaqësues i Komitetit të Stambollit dhe deputetë në parlamentin osman. Burimet gjermane bëjnë të ditur se “Porta Lartë dhe përfaqësuesit Shqiptarë, titullarë në vilajetin e Kosovës dhe atë të Shkodrës, do të bien në ujdi për një reagim të fuqishëm të trojeve të rrezikuara”.<sup>1027</sup>

Andaj, jo rastësisht si vend u caktua Prizreni. Sepse, Vilajeti i Kosovës, si pjesë ku prekej drejtpërdrejt nga copëtimet serbo-malaziase, prej kohësh ishte kthyer në një qendër të protestave të mëdha të të gjitha shtresave: nga ato feudale, të moderuara dhe të klerikëve, me ç'rast prej të gjithëve ishte pranuar slogani atdhetar “mbrojta e vatanit”, i cili nënkuptonte mbrojtjen e atdheut dhe mbrojtjen e Perandorisë njëherësh.

Me organizimin e drejtpërdrejtë të veprimeve për thirrjen e Kuvendit u ngarkua një Komision i posaçëm, shumica e anëtarëve të të cilit ishin nga Prizreni dhe Gjakova. Ndërmjet tyre njihen Ymer Prizreni dhe Ahmet Korenica, ndërsa thirrjen për mbledhjen e Kuvendit e lëshoi qysh në fund të prillit një nga përfaqësuesit më të shënuar të qarqeve atdhetare Ali bej Gucia (më vonë Ali pashë Gucia), feudal vendor dhe kundërshtar i madh i Tanzimatit.

---

Prizreni dhe Shkupi, të cilat gjenden të arkivuara në Arkivin Politik të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Gjermanisë, në kutinë Türki, 143 dhe 124, ku janë të arkivuara edhe disa nga raportet e shtypit të kohës rreth këtyre ngjarjeve. Mveshja e frymës „klandestine“ Lidhjes Shqiptare të Prizrenit bashkë me frymën „revolucionare“, që nuk e kishte, si dhe ngjarjeve të tjera, që do të përcjellin Rilindjen Kombëtare Shqiptare deri te pavarësia kombëtare e vitit 1912, megjithatë, ka të bëjë me klishtë ideologjike dhe ato të patetikës folklorike, që e kanë ngarkuar historiografinë shqiptare (atë të krijuar në Shqipëri gjatë regjimit komunist, por pjesërisht edhe në Kosovë, që ka qenë nën ndikimin e saj), frymë kjo që, siç shihet nga „Historia e Popullit Shqiptar“ e „rishkruar“ në vitin 2002, edhe sot e gjithëditën vazhdon të vuajë nga këto stereotipe.

<sup>1027</sup> Shih telegramin e ambasadorit gjerman nga Stambolli nr. 1276 nga kutia Türki 143, të 2 qershorit 1878 drejtuar Bizmarkut, si deleshë tepër e besueshme, ku jepen hollësi të takimit të zyrtarëve të Portës së Lartë me përfaqësuesit e Shqiptarëve nga vilajeti i Kosovës si dhe drejtuesit e Komitetit të Stambollit, për të cilin thuhet, se është themeluar me lejën e Portës së Lartë si Komitet për Mbrojtjen e të Drejtave të Shqiptarëve.



Kuvendi i Lidhjes u hap më 10 qershor 1878 në Prizren, në metresën e Mehmet Pashës, pranë Bajrak-Xhamisë. Edhe data e mbajtjes nuk ishte e rastësishme, meqë ajo duhej të mbahej para se të fillonte punimet Kongresi i Berlinit që ishte caktuar të mbahej më 13 qershor. Nga të dhënat e tanishme, të cilat janë të pakta, meqë është ruajtur vetëm një pjesë e protokolleve të mirëfillta të mbledhjes, merret vesh se në Kuvend kanë marrë pjesë më shumë se njëqind përfaqësues të shumë krahinave shqiptare, por ku mungonin delegatët e vilajetit të Shkodrës (nisja e të cilave thuhet se ishte penguar nga intrigat e valiut turk Hysen Pasha, por që arsyet janë pak më të thella), ndërsa nga Vilajeti i Janinës do të marrë pjesë vetëm Abdyl Frashëri. Megjithatë, nga këta 110 emra që gjenden dhe shumica vinë nga Vilajeti i Kosovës, kryesisht janë personalitete që kishin marrë pjesë në kryengritjet kundër Tanzimatit, ndër të cilët shquhen Ali bej Gucia, Iljaz pashë Dibra, Hasan pashë Tetova, Ymer Prizreni (kryetar i komisionit organizativ të Kuvendit), Abdullah pashë Dreni, Ahmet Korenica, Shaban bej Prizreni, Jashar bej Shkupi, Shaban bej Peja, Filip Doda, SulejmanVokshi, Shuajip Spahiu, Ali Ibra e të tjerë. Në kuvend morën pjesë si delegatë disa feudalë boshnjakë dhe sulltanistë nga viset e Bosnjës-Hercegovinës. Aty mori pjesë edhe mytesarifi turk i Prizrenit, Qamil Beu bashkë me disa përkrahës së linjës sulltaniste, që bazuar në raportet e konsujve të pranishëm në Prizren, ishte mjaft aktiv. Kjo demanton në tërësi pohimet se Lidhja u mbajt “fshehtë” dhe pa dijen e Portës.

Në bazë të dokumenteve me mangësi të shumta, megjithatë, kuptohet se Kryetar i Kuvendit u zgjodh Iljaz pashë Dibra, ndërsa aty foli Abdyl Frashëri, jo në cilësinë e “kryetarit” e as “të kryesuesit” të Lidhjes, siç është shënuar nga një pjesë e mirë e historiografëve Shqiptarë, por si përfaqësues i Komitetit të Stambollit, paçka se nga disa burime mohohet fare pjesëmarrja e tij në Kuvend.<sup>1028</sup>

Madje edhe nga ajo pjesë e ruajtur e asaj që kishte folur Abdyl Frashëri, siç ishte se “qëllimi i Kuvendit ishte që t’u presim hovin armiqve të pashpirt, duke lidhur besën shqiptare dhe duke u betuar që t’i mbrojmë me gjak trojet që na kanë lënë gjyshërit dhe stërgjyshërit tanë”<sup>1029</sup>, më shumë paraqet një thirrje patriotike se sa që shfaqej program politik. Atmosfera patriotike, jashtë ndonjë programi politik, bëhet e ditur sipas burimeve të konsujve të huaja nga Kuvendi, me

---

<sup>1028</sup> Shih: Krasniqi, Rexhep dr: “Die Albanische Liga”, Vjenë, 1934, punim doktoranture në Uniersietin e Vjenës, i deponuar në bibliotekën “Südost Institut” te Münchenit; Ippen, Theodor: “Beitrag zur innere Geschichte Albaniens im XIX Jahrhundert”, botuar në “Ilyrisch-Albanische Forschungen”, band. I, München-Lepizig, 1916.

<sup>1029</sup> Belegu, Xhafer: “Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe veprimtaria e saj 1878-1881”, Tiranë, 1939, faqe 20.

ç'rast thuhet se kjo atmosferë kishte manifestohet pa dallim se nga cili "krah" vine ajo.<sup>1030</sup>

Ajo që ishte më e rëndësishme, megjithatë kishte të bënte me faktin se Kuvendi ia doli të marrë vendimin për themelimin e një organizate me karakter politik e ushtarak, të një Lidhjeje (*Ittifaku*), me një qendër të vetme drejtuese dhe me degë të saj në të gjitha krahinat e vendit, e cila do të merrte përsipër detyrën që të mbronte me çdo mjet interesat e vendit. Sipas traditës, së bashku me formimin e Lidhjes, u shpall edhe një besë e përgjithshme, në bazë të së cilës duhej të pushonin menjëherë të gjitha veprimet e gjakmarrjes ndërmjet banorëve të krahinave që ishin përfshirë në Kuvendin e Prizrenit.<sup>1031</sup>

Kuvendi themeloi edhe organet e larta. Në krye të Lidhjes qëndronte Këshilli i Përgjithshëm me seli në Prizren, nga i cili do të vareshin degët krahinore. Kryetar i tij u zgjodh Iliaz pashë Dibra. U formua edhe Komiteti Qendror i Lidhjes i përbërë nga tri komisione: komisioni i punëve të jashtme me përgjegjës Abdyl Frashërin, komisioni i punëve të brendshme i drejtuar nga Haxhi Shabani dhe komisioni i të ardhurave financiare i drejtuar nga SuljemanVokshi.<sup>1032</sup>

Aktet e para të Kuvendit të Përgjithshëm ishin: një peticion për çështjen shqiptare, dërguar Kongresit të Berlinit, dhe një peticion, dërguar Portës së Lartë<sup>1033</sup>, *Kararnameja (Akti i vendimeve-kanuni)* dhe *Talimati*(Urdhëresa).<sup>1034</sup>

*Kararnameja (Akti themelor)* kishte gjashtëmbëdhjetë pikë, me të cilin mund thuhej se sanksionohet formimi i Lidhjes si organizatë politike (pika 16) dhe përcaktonte detyrat e saj më të ngutshme. Në pikën 1 theksohej karakteri mbrojtës, ndaj çdo qeverie, përveç asaj të Portës së Lartë, të veprave aktivisht me të gjitha mjetet për të mbrojtur integritetin e vendit.<sup>1035</sup>

---

<sup>1030</sup> Shih:Raportet e ambasadës gjermane nga Stambolli te Arkivi Politik i Ministrisë së Jashtme të Gjermanisë (APMJGJ-PAAA), Bon, kutia Türkei, band 143, raportet 26-31, qershor 1878, të drejtuara Berlinit në bazë të informantëve që kjo ambasadë kishte në Prizren gjatë mbajtjes së Kuvendit

<sup>1031</sup> "*Historia e Popullit Shqiptar*", vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 155.

<sup>1032</sup> Po aty, faqe 156.

<sup>1033</sup> Peticioni, që thuhet se iu dërgua Portës së Lartë (shih: "*Historia e popullit shqiptar*", vëllimi i dytë, Tiranë 2002, faqe 156), me kërkesën për të bashkuar të gjitha trojet shqiptare në një vilajet të vetëm shqiptar, në një vilajet të bashkuar (Tevhidi vilajet) me një "kuvend të bashkuar" në krye me një administratë të bashkuar, buxhet dhe ushtri të veçantë, pra të pajisur me autonomi administrative dhe kulturore, në të vërtetë nuk gjendet në asnjë dokument të Kuvendit të Lidhjes. Fjala mund të jetë për një peticion që Komiteti i Stambollit ia kishte drejtuar përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha në Stamboll, por pa iu referuar Kuvendit të Prizrenit. Ky ndodhet edhe në dokumentet e arkivuara të Arkivit Politik të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Gjermanisë, në kuadër të peticioneve dhe letrare drejtur Kongresit dhe përfaqësuesve të tyre, në kutinë Türkei, 143.

<sup>1034</sup> Po aty, faqe 156.

<sup>1035</sup> Shih: "*Kararname*", e botuar si dokument në tërësi të "*Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912*", përgatitur nga Stefanaq Poplo dhe Selami Pulaha, Tiranë, 1878, faqe 40-41.

Në nenin 4 kur thuhet se “me ligjet e lara të shariatit, ne do të mbrojmë jetën, pasurinë dhe nderin e shokëve besnikë të besimit jomysliman, ashtu si për vetë”,<sup>1036</sup> bën të ditur për ruajtjen e karakterit islamik, gjë që si formulim në ato rrethana ishte edhe i pashmangshëm.

Në të vërtetë, frymën kombëtare nga e cila ishte e privuar më 10 qershor ditën e hapjes së Kuvendit dhe veçmas nga kërkesat për bashkimin e katër vilajeteve shqiptare në një, që ishte një formë e autonomisë, me të cilën sigurohej mbrojtja e vendit nga copëtimet e mëtutjeshme që kërcënonin nga të gjitha anët, Lidhja filloi ta animojë qysh në Kuvendin e Përgjithshëm, në Prizren, më 1 korrik 1878.

E kompletuar me 96 delegatë nga Kosova dhe me delegatët nga Shkodra (26 sish) dhe Vilajeti i Janinës (me 20), pas një diskutimi të gjerë, Kuvendi miratoi një Rezolutë ose Kanun të ri për Lidhjen e Prizrenit, me të cilin u bënë hapat e rëndësishëm në përpunimin e mëtejshëm të programit të Lidhjes. Sepse, Kanuni i ri, e shpalli botërisht organizatën e themeluar në Prizren si *Lidhje Shqiptare* dhe organin i saj qendror e quajti *Komiteti Kombëtar*.<sup>1037</sup>

Statuti i ri ishte pastruar nga ndonjë formulim me karakter fetar islamik dhe nga ideja e besnikërisë ndaj Perandorisë Osmane, që kishte pasur vend në *Kararname*.<sup>1038</sup> Në tekstin e Kanunit thuhej shprehimisht se Lidhja do të luftonte për të

---

<sup>1036</sup> Po aty, faqe 41.

<sup>1037</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 160.

<sup>1038</sup> Revista “*Tercüman-ı Şark*” (Përkthyesi i Orientit) botoi *Kararnamen* e aprovuar në Kuvendin e Lidhjes të 1 korrikut 1878 në shtatë pikat e mëposhtme: 1) Për të ruajtur të drejtën e sovranitetit të madhërisë së tij Padishahit (sulltanit) mbi Shqipërinë dhe të mos u lëshojë popujve fqinjë një centimer të territoreve shqiptare. 2) Për të institucionalizuar (krijuar) një vilajeti me emrin “Vilajeti i Shqipërisë”, i cili do të përbëhet nga vilajet e Kosovës, Shkodrës dhe Janinës. Të emrohet si guvernator i këtij vilajeti një person i cili është i arsimuar, i aftë dhe i ndershëm, dhe i cili e njuh mire situatën dhe nevojat e vendit dhe zakonet e adetet e popullsisë. 3) Të caktojë në administratë dhe gjyqësor të këtij vilajeti, nëpunës të cilët kanë njohuri të mirë të gjuhës së vendit, deri në atë pikën e kuptuarit të kërkesave të personave në nevojë dhe të jenë në gjendje të komunikojnë me ta pa përkthyes. 4) popullsia lokale duhet të ketë të drjetë të zgjedhët në mënyrë të barabartë, pa marrë parasysh dallimet fetare apo klasore, në këshillat e nahijes (rajonet). Në të njëjtën mënyrë duhet të zgjedhën këshillat e Kazave, të cila, nga ana tjetër, duhet të zgjedhin këshillat e Sanxhakut. Sa i përket Këshillit të Madh të Vilajetit, do të zgjedhët nga Këshillat e Sanxhakut. 5) Të institucionalizohet (krijohet) një këshill i cili do të përbëhet nga anëtarët e zgjedhur të cilat do të takohen çdo dy muaj në qytetin kryesor të vilajetit. Ky këshill do të informojë Këshillin e Madh të Vilajetit se për çka ka nevojë popullata për ekzistencën e saj, reformat që duhet të kryhen, si dhe gabimet dhe (ankesat ndaj) e punonjësve. Ky këshill do të caktojë përfaqësuesin e saj si Prokurori i Përgjithshëm, i cili në bashkëpunim me punonjësit e tjera të nevojshëm, do të bëjë drejtësi. Shkurtimisht, ky këshill do të veprojë si gjykatë para Këshilli të Madh. Qeveria perandorake është e detyruar gjithashtu të ekzekutojë vendimet e këtij këshilli. 6) Gjuha osmane do të mbetet gjuha zyrtare në korrespondencën në mes të Vilajetit dhe Portës së Lartë. Megjithatë, këshillat e gjyqsori duhet të përdorin gjuhën shqipe kur gjykojnë çështjet brenda kompetencave të tyre. Në shkollat e mesme që aktualisht ekzistojnë në Shqipëri, si në ato që do të formohen më pas, së bashku me studimet e gjuhës osmane, shkencës dhe arteve, lëndë për mësimin e shkrim leximit të shqipes duhet të futet. Një pjesë e të ardhurave të Vilajetit duhet të ndahen për zhvillimin dhe ecjen perpara të arsimit, i cili do të bëjë vendin të dalë nga injoranca në të cilën ajo gjendet. 7) Të organizojë një klasë të ushtrisë kombëtare, pa marrë parasysh dallimet fetare. Kjo

drejtat kombëtare shqiptare dhe se veprimtarinë e saj do ta shtrinte vetëm në trojet shqiptare. Ajo i jepte të drejtë Komitetit Kombëtar të formonte nënkomitete të Lidhjes në qendrat e sanxhaqeve të Shqipërisë, të organizonte një ushtri të armatosur për të mbrojtur trojet shqiptare, të shpallte mobilizimin ushtarak të të gjithë burrave të aftë për armë, të vilte, për nevojat e veta buxhetore, një sërë taksash të ndryshme dhe të jepte dënime penale kundër dezertorëve nga Lidhja Shqiptare, me çka mund të thuhet se Lidhja kishte krijuar rrethanat për marrjen mbi vete funksionet e një qeverie.<sup>1039</sup>

Kanuni i miratuar më 2 korrik 1878, shënon një fitore të rëndësishme të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në gjirin e Lidhjes së Prizrenit. Në të vërtetë, me këtë të drejta, që u sanksionuan në kanunin e 2 korrikut 1878, Lidhja Shqiptare e Prizrenit fitoi bazën ligjore për të ngritur shkallë-shkallë një shtet autonom shqiptar brenda shtetit perandorak osman.<sup>1040</sup>

## KONGRESI I BERLINIT 1878

Për popujt e Europës dhe jo vetëm të Europës, Kongresi i Berlinit i vitit 1878 shënon një ngjarje të rëndësishme, meqë nga rrjedhat dhe vendimet e tij do të ndikohen jo vetëm realitetet shoqërore të kohës, por edhe ato historike në përgjithësi, të cilat do të marrin kahun e krizave që do të vazhdojnë në forma të ndryshme për t'u kthyer deri tek ajo që mund të quhet gjeostrategji dhe gjeopolitikë. “Natyrisht se shkas për një zhvillim të tillë paraqitnin, në njërën anë, si dobësimi i vazhdueshëm i Perandorisë Osmane, që nuk kishte si të përfundonte ndryshe veçse me rrënimin e saj dhe në tjetrën anë lindja e fuqive të reja, Gjermanisë dhe Italisë, që bënte të ruhej baraspesha e deriatëhershme ndërkombëtare.”<sup>1041</sup>

Ky ekuilibër u prish sidomos pas fitores së Rusisë mbi Turqinë në vitin 1877 dhe pas nënshkrimit të ngutshëm të Paqes së Shën Stefanit, në mars të vitit 1878,

---

ushtri, e cila me siguri do të numrojë në radhët e saj 200,000 burra, do të trajnohet në përputhje me rregullat organizative e saj të veçantë. Shteti do të caktojë oficerë si instruktorë të cilët do të trajnojnë ushtarët”.

<sup>1039</sup> Shih: Urdhëresa *Talimati* i Lidhjes, i aprovuar për organizimin e administratës dhe të ushtrisë së saj te “*Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912*”, përgatitur nga Stefanaq Pollo dhe Selami Pulaha, Tiranë, 1978, faqe 40.

<sup>1040</sup> “*Historia e popullit shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 161.

<sup>1041</sup> Otmar, Karl: “*Bismarcks Aussenpolitik und der Berliner Kongres*”, Wiesbaden, 1978, faqe 7

me ç'rast Rusia, nëpërmjet krijimit të shtetit të Bullgarisë po fitonte pjesën më të ndjeshme të Ballkanit dhe po dilte në Mesdhe.<sup>1042</sup>

Ishte më se e qartë se Bullgaria e madhe e Shën Stefanit nuk paraqiste tjetër përpos një dorë të djathtë të Ruisë, e cila kështu po realizonte ëndrrën e kamotshme për depërtim të thellë në Ballkan dhe për një hegjemonizëm në këtë pjesë nevralgjike të Europës, pikërisht aty ku historikisht zhvillohej ndeshja midis Perëndimit dhe Lindjes dhe në njëfarë mënyre edhe mbaheshin çelësat e gjeostrategjisë botërore.

Paqja e Shën Stefanit me ato që solli, dridhi me të drejtë që të gjitha fuqitë europiane, të cilat nuk kishin si të mos përqendroheshin kundër realiteteve që solli ajo në planin politik dhe diplomatik. Kështu, Anglia, e cila kishte depërtuar thellë në Lindjen e Mesme dhe që edhe më tutje kërkonte shtigje të reja përtej Indisë, me një paqe të tillë, siç ishte ajo e Shën Stefanit, e detyruar nga Rusët, shihte se është e rrezikuar së tepërmi.<sup>1043</sup> Ndërsa, Austro-Hungaria dhe Italia, sidomos e para, me krijimin e shtetit të madh bullgar në Ballkan, kishte frikë të madhe se mos Rusia, me pansllavizmin e saj, pas një traktati të tillë, po ua mbyllte dyert të tjerëve në këtë pjesë të Europës.<sup>1044</sup>

Përpos shumicës së popujve të Ballkanit, që ishin të pakënaqur me Traktatin e Shën Stefanit, edhe fuqitë e mëdha, në krye me Anglinë, iu kundërvunë vendimeve të tilla. Bile, dukej se nëse Rusia do të vazhdonte të ngulte këmbë se paqja e Shën Stefanit ishte fjala e fundit e saj, atëherë nuk mbetej tjetër përveçse një luftë e pashmangshme midis Anglisë dhe Ruisë, në të cilën do të përfshiheshin edhe të tjerët.<sup>1045</sup> Shi për këtë arsye, u shtrua nevoja e ngutshme e një takimi ndërkombëtar, ku fuqitë e mëdha do të bisedonin shtruar për të gjitha çështjet, para se këtë ta bënin armët. Në këtë drejtim, Gjermania u tregua më e angazhuara dhe pothuajse mori përsipër që të gjitha ndërmjetësimet, qoftë të uljes së tensionimeve që u shfaqën, qoftë rreth përgatitjes së një kongresi të madh, ku përveç Ruisë dhe Perandorisë Osmane, Anglisë e Austro-Hungarisë, Italisë dhe Francës do të merrnin pjesë edhe përfaqësuesit e popujve, të cilët luftonin për pavarësi kombëtare, por që aty nuk do të ishin për të vendosur, por për të parë si do të vendosnin fuqitë e mëdha. Bizmarku, që kishte bërë aq shumë për unitetin dhe prosperitetin e shtetit të ri gjerman, tashmë gjendej para një detyre tejet të rëndë,

<sup>1042</sup> Knap, Verner: "Der Berliner Kongres", Wiesbaden, 1978, faqe 13.

<sup>1043</sup> Po aty, faqe 15.

<sup>1044</sup> Otmar, Karl; Bismarcks...", faqe 19

<sup>1045</sup> Gothusen, Klaus-Detlev: "Die Oreintalische Frage als Problem der europeische Geschichte", "Südost-europa Mitteilungen", Nr. 4-78, faqe 4.

që në një rën anë sa më shumë që të ishte e mundur t'i pajtonte të gjitha kundërshtitë dhe konfliktet në shpërthim e sipër midis fuqive të mëdha dhe në tjetrën anë, të minonte sa më shumë vendimet e Shën Stefanit, ku Rusia do të mbahej sa më larg Europës, por që një gjë e tillë të arrihej pa ndonjë shqetësim të madh a luftë midis superfuqive.<sup>1046</sup>

Por, si të arrihej diçka që „Mishi të piqej e helli të mos digjej“, kur gjendja pas marrëveshjeve të Shën Stefanit ishte aq e nderë dhe e ashpërsuar njëherësh sa që shpesh dukej se qëllimi i tillë madje ngjante i paarritshëm. Vetë Bizmarku, që mori rolin e ndërmjetësuesit të shkathët dhe për këtë u mbiquajt edhe *makleri* madh, thotë se „Gjermanët nuk kishin ndonjë interes të drejtpërdrejtë në Ballkan a më larg, në një kohë kur edhe më tutje kishim probleme të brendshme, por gjithsesi ishim të shqetësuar se çfarë po ndodhte përreth nesh dhe mund të kishte ndikim te ne. Rusia ishte e futur thellë në Ballkan dhe kjo bëri që Austro-Hungaria disa herë të protestojë dhe filloi të nxiste Anglinë të lidhnin një aleancë kundër Rusëve. Po ashtu edhe Italia, e cila po përgjonte se ç'ndodhte dhe ishte e gatshme që prore të pillte ndonjë sherr, po shqetësohej. Franca, ndonëse pak si e tronditur nga ngjarjet e fundit, megjithatë edhe ajo tregonte interesim për ato që ndodhnin dhe nuk pajtohej me gjendjen e re që të jetë me favore të njëanshme për Rusinë. Pra, ishte më se e qartë se Fuqitë e Mëdha mund të rrokeshin me njëra-tjetrën dhe kjo, dashur padashur do të përfshinte edhe Gjermaninë, e cila nuk ishte e interesuar të futej në ndonjë konflikt. Prandaj, kush përpos nesh duhej ta merrte rolin e një pajtuesi? Ne ishim të vetmit që nuk kishim dorë në Ballkan dhe në Lindjen e Afërme. Neve pra na binte barra e përgatitjes së takimit të tillë, ku për herë të parë do të bisedohej që të mos ndodhte një konflikt midis fuqive të mëdha.“<sup>1047</sup>

Si e tillë, sipas shumicës së studiuesve të kohës, Gjermania njëmend ishte shteti më i përshtatshëm për ndërmjetësime të tilla, ndërsa Bizmarku politikani më energjik, i cili do të duhej të ndërmjetësonte midis palëve të elektrizuara.<sup>1048</sup>

Natyrisht se për të marrë një rol të tillë nuk ishte shumë e lehtë, sepse, siç thotë Emil Ludvig, njëri ndër studiuesit më të mirë të Bizmarkut dhe të Kongresit

---

<sup>1046</sup>Otmar, Karl: „Bismarcks...“, faqe 21.

<sup>1047</sup>Ludvig, Emil: „Bismarck“, Botoi „Wilhelm Goldman Verlag“, 1926, faqe 27.

<sup>1048</sup>Në qershor të vitit 1978, në Majnc të Gjermanisë u mbajt simpoziumi ndërkombëtar „Kongresi i Berlinit dhe kriza Lindore“. Në këtë tubim shkencor morën pjesë mbi 60 shkencëtarë nga Europa dhe Azia, të cilët Gjermaninë e Bizmarkut e vlerësuan si shtetin më të përshtatshëm për një takim të tillë. Rusia, aso kohe, pas fitores ndaj Perandorisë Osmane në Berlin pranonte të vinte, sepse mendonte se Gjermania edhe nëse nuk ishte në anën e saj, nuk ishte kundër saj. Këtë qëndrim e cekën Verner Knopp, Teodor Shider, Loar Gall e të tjerë.

të Berlinit, „Rrethanat atëbotë ishin të tilla që kërkonin një personalitet të fortë, i cili do ta gjunjëzonte në mënyrë diplomatike Rusinë dhe do të bënte që baraspesha e forcave prapë t’u shkonte për shtati atyre që ishin kundër Rosisë, gjë që e gjithë kjo duhej të bëhej me një diplomaci finoke. Këtë mund ta bënte vetëm Bizmarku“.<sup>1049</sup>

Kështu, periudha prej marsit të vitit 1878 e deri në qershor të po këtij viti, kur do të fillonte punimet Kongresi i Berlinit, nuk mund të ishte ndryshe përveçse plot e përplot vlime diplomatike, ku përvijoheshin vijat e qarta të vendimeve që do të pasonin në Kongres. Bizmarku ishte figura kryesore e këtyre bisedimeve. Ky, me anën e kanaleve diplomatike bënte përpjekje që t’i harmonizonte qëndrimet para se t’i fillonte punimet Kongresi.<sup>1050</sup>

Nga të dhënat që mund të shihen, del se pas kërcënimeve të para të drejtpërdrejta midis Rosisë dhe Anglisë, që erdhën menjëherë pas nënshkrimit të paqes së Shën Stefanit (në fund të marsit dhe në fillim të prillit) me ç’rast Rusia haptas hodhi poshtë propozimin e Anglisë për mbajtjen e një kongresi të ri pas Shën Stefanit, forcat e tjera përreth, si Austro-Hungaria dhe Franca filluan të ofronin rezoluta dhe propozime për kapërcimin e krizës që solli paqja e Shën Stefanit. I njohur është, për shembull, propozimi i Austro-Hungarisë i 26 marsit të vitit 1878, që i ka bazat në Marrëveshjen e Rajhshtatit të vitit 1876 dhe Konventa ruse-austro-hungareze e 15 janarit të vitit 1877. Kjo konventë, përveç të tjerash, parasheh që pas shkatërrimit të Perandorisë Osmane në Ballkan të krijoheshin shtetet e pavarura: Bullgaria, Rumelia dhe Shqipëria. Sipas burimeve gjermane, çështja e Shqipërisë së pavarur, sipas kësaj marrëveshjeje, është jo gjithaq e sqaruar, sepse zihen ngojë dy terma: *vetëqeverisje* dhe *autonomi*, të cilat përdornin Andrashi dhe Goroshkovi.<sup>1051</sup>

Pra, ofroheshin zgjidhje, të cilat, në të vërtetë kundërshtonin vendimet e marra pak më parë në Shën Stefan, por pa iu mbyllur rruga realiteteve të reja të krijuara pas Luftës ruse-turke, e fituar nga Rusia, e cila, dashur a padashur, nuk mund ta kthente gjendjen ku ishte, pa iu dhënë njëfarë kundërshpërblimi Rosisë, por mendohej që ky shpërblim të ishte sa më i vogël dhe sa më i parëndësishëm në planin strategjik.

---

<sup>1049</sup> Ludvig, Emil, po aty, faqe 36.

<sup>1050</sup> Shih: Albers, Detlev: “*Reichstag und Aussenpolitik 1871-1879*”, faqe 101; Gundermann, Iselin: “*Berlin als Kongressstadt*”, Berlin 1878, faqe 54;

<sup>1051</sup> Shih: Peter Bartl “*Die Albanische Muslims zur zeit der Nationalunabhenigkeitsbewegung 1878-1912*” dhe Hans Dietrich Schanderler “*Die albanienpolitik Österreich-Ungarns und Italien 1877-1908*”).

Në këtë kohë edhe vetë Rusia, e shtyrë nga gjendja e krijuar ndërkombëtare, që do të mund të shpinte në një aleancë të re midis Anglisë, Austro-Hungarisë dhe Francës kundër saj, lëshoi pe në të mirë të pranimit të bisedimeve të drejtpërdrejta, duke treguar në këtë mënyrë se megjithatë është e gatshme të heqë dorë nga Shën Stefani në dobi të faktorizimit të mëtutjeshëm të saj në sferën ndërkombëtare, si fuqi e pashmangshme e kohës. Shuvalovi, kryeministër rus, brenda një kohë të shkurtër vizitoi dy herë Berlinin, ku u takua me Bizmarkun. Më 9 maj të vitit 1878 dhe më 20 maj Bizmarkut iu ofrua besimi i shtetit rus rreth organizimit dhe mbajtjes së një kongresi ndërkombëtar, ku do të shqyrtoheshin çështjet që dolën pas Luftës ruse-turke.<sup>1052</sup>

Kështu, më 22 maj Shuvalovi, në Petersburg, priti një delegacion anglez dhe kjo jepte të kuptohej qartazi se një kongres i tillë do të organizohej. Më 28 dhe 29 maj edhe Austro-Hungaria bëri të ditur propozimin përfundimtar për zgjidhjen e çështjes lindore.<sup>1053</sup>

Fuqitë e Mëdha nëpërmjet kanaleve të shumta diplomatike dhe takimeve të njëpasnjëshme kishin përballuar atmosferën e kërcënimit me luftë dhe po i afrohin qëndrimet e tyre para se ato përfundimisht t'i hidhnin në tryezën e bisedimeve të Kongresit të Berlinit, që do të mbahej pas pak. Për vetë kongresin mbetej ratifikimi përfundimtar i marrëveshjeve dhe çështje të tjera që merreshin si anësore, e që nuk do të duhej të luanin ndonjë rol aq të madh, pa marrë parasysh rëndësinë që mund ta kishin më vonë.

Dhe, thelbi i marrëveshjeve ishte ky: Rusia duhej të hiqte dorë nga depërtimi i saj i madh në Ballkan përmes Bullgarisë dhe se do të bëheshin përpjekje që Perandorisë Osmane nëpërmes *status quo-s* prapë t'i zgjatej jeta në pjesën europiane, ani pse mbretëronte bindja se kjo nuk paraqiste tjetër veçse përpjekje për të fituar kohë të domosdoshme nga të gjithë për të vendosur se si do të mbushej hapësira që për pesë shekuj ishte mbikëqyrur dhe sunduar nga Perandoria e Bosforit.

Anglia në këtë drejtim ishte posaçërisht aktive dhe kërkonte që para se të fillonte Kongresi i Berlinit shumë gjëra të bëheshin të qarta me Rusinë dhe me

---

<sup>1052</sup> Otmar, Karl: "Bismarcks...", faqe 10; "Die Berliner Kongress von 1878: Die Politik der Grossmächte und die Probleme der Modernisierung in Südosteuropa in der zweiten Hälfte des 19 Jahrhunderts", ed. Ralph Meville und Hans-Jürgem Schröder, Wiesbaden, 1982, f. 400.

<sup>1053</sup> Sipas Graf Andrashit, ministër i jashtëm i Austro-Hungarisë, del se: Bullgaria do të mbate vetëm një pjesë të vogël të territorit që ia ka caktuar Shën Stefani. Rusia, pas dy vitesh duhej të largohej nga ajo pjesë e Bullgarisë, kufijtë e së cilës do të caktoheshin në Kongresin e Berlinit, ndërsa Serbisë dhe Malit të Zi do t'u lejoheshin zgjerime të vogla territoriale. (Shih: "Berliner Kongres 1878", Harald Bohland Verlag, Wiesbaden, 1978, faqe 15)



Turqinë, si dhe me situatën në Ballkan. Kështu, më 30 maj, pas shumë ndër-mjetësimesh të palës gjermane, asaj franceze dhe deri diku italiane, bëhet takimi i njohur midis Shuvalovit dhe lordit Solsberi. Në këtë takim historik Rusët përfundimisht do t'i pranojnë qëndrimet dhe propozimet për modifikimin e paqes së Shën Stefanit.<sup>1054</sup> Çdo gjë tjetër pas këtij takimi ishte formalitet, meqë rrugët e marrëveshjes tashmë ishin të hapura. Rreziku i konfrontimit midis Rusisë dhe Anglisë ishte kapërcyer.<sup>1055</sup> Ishte më se e qartë se Europa për herë të parë në një përbërje të tillë do të shqyrtonte çështje aq të rëndësishme, të cilat do t'i ndërronin raportet e kohës.

Më 3 qershor, gjashtë përfaqësuesit e fuqive të mëdha: të Anglisë, të Rusisë, të Austro-Hungarisë, të Francës, të Italisë dhe të Gjermanisë, morën ftesat për Kongresin e Berlinit, i cili duhej të fillonte punimet më 13 qershor.<sup>1056</sup>

Në këtë Kongres u thirrën edhe përfaqësues të shteteve të Ballkanit (të pavarura, ose autonome) si dhe përfaqësues të popujve, të cilët asokohe luftonin për pavarësi në Ballkan dhe në Lindjen e Afërme.<sup>1057</sup>

Ata vinin në Kongres si vëzhgues, që herë pas herë, u lejohej hyrja në sallën solemne të Kongresit, me rastin e paraqitjes së parashtresave me shkrim, ose të dhënies së ndonjë deklarate të shkurtër gojore, siç ishte rasti me përfaqësuesin e delegacionit grek, Theodoros Delijanisi, të cilit me ndërhyrjen e ministrit të jashtëm të Francës, William H. Haddington, iu lejua që të parashtronte kërkesën për zgjerimin e territoreve të Greqisë së Madhe për një gjysmë ore. Rumunëve, po ashtu, iu lejua, në seancën e dhjetë, më 1 korrik, të paraqitnin kërkesat e tyre për Transilvaninë. Ngjashëm ndodhi edhe me përfaqësuesin e Serbisë, ministrin e jashtëm, Jovan Ristiç, të cilit nuk iu lejua roli i vëzhguesit në Kongres, siç kishte kërkuar Rusia. Atij dhe delegacionit serb, iu lejua hyrja disaminuteshe në sallën e Kongresit, vetëm t'i paraqiste kërkesat me shkrim pa të drejtë t'i arsyetonte.<sup>1058</sup>

Në Kongres nuk u thirrën përfaqësuesit e popullit shqiptar. Kjo as që mund të pritej, meqë në kuadrin e Perandorisë Osmane, myslimanët kishin tretmanin e milleti-osman, ndërsa të krishterët e të dy riteve, trajtoheshin si "rumë". Kjo, megjithatë, nuk e përjashtoi fjalën "Shqipëri" si një etni, e cila përbëhej nga disa vilajete në kuadër të Perandorisë Osmane, e cila shtrohej në kërkesat e vendeve fqinje (Serbisë, Malit të Ti dhe Greqisë), që pjesët e tyre të përfshiheshin në kua-

---

<sup>1054</sup> Po aty, faqe 16.

<sup>1055</sup> Shih: Robert Howard Lord: *"The Congress of Berlin"*, Cambridge, 1917, faqe 62.

<sup>1056</sup> Po aty, faqe 17.

<sup>1057</sup> Shih: Gundermann, Iselin: *"Berlin als Kongresstadt"*, Berlin 1878, faqe 54.

<sup>1058</sup> Shih: Glenni, Misha: *"Histori e Ballkanit 1804-1999"*, Tiranë, faqe 141-142.

dër të shteteve të tyre. Ndaj me të drejtë vlerëson historiani gjerman Petër Bartle, se Kongresi nuk e pranonte kombësinë shqiptare, por etninë e tyre e njëjtte si “Shqipëri”. Madje, këtë e bënë edhe përfaqësuesit e Portës në Kongresin e Berlinit sa herë që ziheshin ngojë pretendimet e serbëve, grekëve dhe të malaziasve ndaj tyre, me ç’rast ato theksoheshin “vilajete shqiptare”, që thuhej se duhej të mbeteshin të plota në kuadër të Perandorisë Osmane, por jashtë çfarëdo statusi autonom, edhe pse kjo, në kuadër të reformave të brendshme, u lejohej.<sup>1059</sup>

Kongresi i Berlinit i filloi punimet zyrtarisht më 13 qershor të vitit 1878 dhe zgjati deri më 13 korrik të po këtij viti dhe pati 20 seanca.<sup>1060</sup> U mbajt në rezidencën zyrtare të Bizmarkut në qendër të Berlinit, në Pallatin Radziwill. Ndërtesë imponante, e vendosur prapa Unterden Linden-it në Wilhelmstrasse, duhej të pasqyronte edhe fuqinë diplomatike dhe politike të shtetit të bashkuar gjerman, krijimi i të cilit tashmë kishte filluar të ndryshonte ekuilibri europian. Në sallën e seancave të kongresit, në katin e parë, të shtatë delegacionet zunë vend në tavolinën e madhe në trajtë patkoi, sipas rendit alfabetik të frëngjishtes. Në cilësinë e kryetarit, u hap nga kancelari gjerman Bizmark, i cili pranë e kishte sekretarin e kongresit, Joseph Mariavon Radoviz, një diplomat të shkathtë gjerman, që u bë i njohur edhe në sajë të shënimeve personale që la për punimet e Kongresit.<sup>1061</sup>

Nën udhëheqjen e Bizmarkut, në tryezën e bisedimeve u ulën: delegacioni i Anglisë, i prirë nga lordi Solsberi; delegacioni i Rusisë, i kryesuar nga Shuvalovi dhe Goroshkovi; i Perandorisë Osmane, i kryesuar nga Sadullah Bej dhe Mehmed Ali Pasha (Maxharr Pasha); i Austro-Hungarisë, i kryesuar nga Andrashi, si dhe delegacioni i Francës dhe ai i Italisë. Në Kongres morën pjesë gjithashtu edhe shumë përfaqësues të shtypit të kohës, vëzhgues dhe politikanë nga Gjermania dhe vendet fqinje.<sup>1062</sup>

Për opinionin dhe për të pranishmit, me një interes të veçantë ishte pjesëmarrja e personaliteteve të larta, si e Goroshkovit, kryeministër rus, pastaj e kryeministrit të Anglisë Baconsfield dhe prania e ministrit të Punëve të Jashtme të Francës William Waddington.<sup>1063</sup>

Kundruell këtij korifeu prominent, kancelari gjerman kishte vetëm një qëllim të lidhur me politikën e jashtme - mbajtjen e një ekuilibri fuqie, që do të pen-

<sup>1059</sup> Bartl, Peter, vepra e cituar, faqe 116.

<sup>1060</sup> Buxhovi, Jusuf: “Kongresi i Berlinit 1878”, Prishtinë, 2008, faqe 13.

<sup>1061</sup> Rreth kujtimeve të von Radiwizt, shih: Gudermann, Iselin: “Berlin als Kongressstadt”, Berlin 1878.

<sup>1062</sup> Po aty, faqe 14.

<sup>1063</sup> Po aty, faqe 15.

gonte krijimin e aleancave antigjermane, edhe pse guri i themelit të kësaj strategjie tashmë ishte qitur me Lidhjen e Tre Perandorëve (marrëveshje jozyrtare që bashkonte Berlinin, Shën Petërburgun dhe Vjenën).

Nga përbërja e delegacioneve dhe e paraqitjes së tyre mund të shihej fare lehtë se këto palë që gjendeshin para një konflikti të armatosur (Anglia dhe Rusia), në Berlin kishin ardhur për të demonstruar edhe forcën politike dhe atë diplomatike. Ishte pra, më se e dukshme që përkundër bisedimeve paraprake, të cilat u zhvilluan gjatë dy muajve të fundit, dhe shumë nga vendimet tashmë ishin marrë (në prill dhe në maj), megjithatë, Berlini, duhej të kthehej në një arena diplomatike dhe politike të nivelit më të lartë të kohës.

Sipas protokolleve origjinale të Kongresit të Berlinit, del se qysh në fillim të seancës së dytë pati njëfarë fërkimi midis Anglisë dhe Rusisë. Kryeministri britanik, protestoi kundër pranisë së flotës ruse në afërsi të Kostandinopojës, ndërsa kryeministri rus Goroshkov tha se pikërisht prania angleze në atë pjesë të detit ka bërë që edhe Rusët të mos tërhiqen.<sup>1064</sup>

Bizmarku, si drejtues i Kongresit, kërkoi që këto akuza të ndërpriten dhe të mos përqendrohet vëmendja tek çështjet “e jashtme” që mund ta çrregullonin punën e paraparë. Ai, bile, edhe pse ato ditë u bë një atentat kundër mbretit Vilhelmi i Parë, nuk deshi që tubimi të shpërqendrohej nga ajo ngjarje.<sup>1065</sup>

Megjithatë, punimet e Kongresit nuk ishte e mundur të kishin rrjedhë fare të qetë, meqë fjala ishte për çështje të mëdha dhe tejet të rëndësishme, të parat të një natyre të tillë, edhe pse ishte më se e qartë se fuqitë e mëdha pjesëmarrëse parimisht ishin marrë vesh për disa më kryesoret, siç ishin ato që realitetet që kishte krijuar paqja e Shën Stefanit, me ndonjë përjashtim të vogël, të anuloheshin me ç’rast, status quo-s i vazhdohej jeta.

Por, shqetësimet dhe kacafytjet qenë më të ndjeshme midis seancës së katërt dhe të gjashtë, sepse zhvillohej një betejë e madhe për largimin e ndikimit por edhe të pranisë së drejtpërdrejtë të Rusisë nga Ballkani, edhe pse gjatë bisedimeve paraprake dukej se rreth kësaj ishte arritur një pajtim parimor edhe nga rivalët më të fortë, Anglia dhe Rusia. Kështu, në seancën e pestë dhe të gjashtë u pranua propozimi i Austro-Hungarisë që Rusia brenda gjashtë muajsh të largohej nga Rumelia Lindore; brenda nëntë muajsh të largohej edhe nga Bullgaria, e cila u nda në dy pjesë. Rusia duhej të largohej edhe nga Rumunia brenda dymbëdhjetë muajsh.

---

<sup>1064</sup> Buxhovi, Jusuf: “Kongresi i Berlinit 1878”, Prishtinë, 2008, faqe 18.

<sup>1065</sup> Po aty, protokollu, nr 1, faqe 101.

Në seancën e tetë u bisedua për njërin ndër pikat më të ndjeshme të Kongresit – për çështjen e Bosnjës dhe Hercegovinës. Me propozimin e Anglisë, Kongresi do të duhej t'i hapte rrugë Austro-Hungarisë për në këtë krahinë. Andrashi kishte luajtur një rol të madh në këtë drejtim, me ç'rast në saje të shkathëtisë së tij që para fillimit të Kongresit kjo çështje kishte filluar të zgjidhej në dobi të Vjenës, edhe pse Hungaria, si pjesë e Monarkisë, nuk ishte gjithaq e kënaqur me këtë vendim nga shkaku i vetëm se në pjesën juglindore të saj shtohesh numri i Sllavëve, gjë që prishte raportet etnike midis Hungarezëve dhe Sllavëve të Jugut.<sup>1066</sup>

Në seancën e tetë u hoq përfundimisht nga rendi i ditës çështja e Bosnjës dhe Hercegovinës, ndërsa për Serbinë u vendos të bëhej shtet i pavarur. Me këtë rast u tha se ajo duhet të respektonte kombet e tjera brenda kufijve të saj, bashkë me përkatësitë fetare dhe identitetin etnik. Po ashtu, në këtë seancë që u mbajt më 26 qershor, Serbia, me insistimin e përfaqësuesit të Perandorisë Osmane Mehmed Ali Pasha dhe të Andrashit, mori për obligim se do të ketë qëndrim të drejtë ndaj popullatës joserbe në pjesët jugore që iu dhanë, me çka zotohej se nuk do të ndërmerre asnjë veprim që popullatën e këtyre vendeve ta detyronte të braktiste trojet e veta. Ministri i jashtë i Serbisë, Ristiç, në emër të princit Millan, lexoi një deklaratë, me të cilën ky vend merr përsipër mbrojtjen e të gjitha të drejtave të popullatës joserbe që do të përfshihen në hapësirën e shtetit serb, nga ushtrimi i lirë i religjionit e deri te mbrojtja e pronës. Sipas pikës 36, Serbia zgjerohej me Kurshumlinë dhe një pjesë të krahinës së Vranjës dhe me qytetin e Vranjës.<sup>1067</sup>

Edhe përkundër këtyre përfitimeve si dhe pavarësisë, Serbia ishte kushtëzuar nga Austriakët që të paguante një sipërmarrës, baronin Hirsch, për të ndërtuar një hekurudhë nga Beogradi deri në kufirin maqedonas-osman. Përveç kësaj Serbia duhet të bashkëpunonte për ndërtimin e një hekurudhe tjetër në drejtim të Bullgarisë e të Turqisë. Serbisë iu kërkua edhe nënshkrimi i një marrëveshje tregtare me Austrinë si dhe të pranonte planet e Austrisë për një regjim lundrimi në Danub, me çka Austria duhej ta fitonte statusin tregtar “të vendit më të favorizuar”. Kjo strategji, me të cilën Vjena, Serbinë e kthente në një vasal, kulmoi në vitin 1881 me nënshkrimin e një traktati të fshehtë me princin Millan për mbrojtje.<sup>1068</sup>

Në seancën e trembëdhjetë, që u mbajt më pesë korrik, për herë të parë u bë fjalë për çështjen e autonomisë lokale për popullatën katolike të Mirditës. Ky

---

<sup>1066</sup> Po aty, protokolli, nr 1, faqe 103.

<sup>1067</sup> Po aty, protokolli, nr 8, faqe 160

<sup>1068</sup> Shih: Glenni, Misha: “*Histori e Ballkanit 1804-1999*”, Tiranë, faqe 150.

propozim doli nga përfaqësuesi i Austro-Hungarisë dhe ai i Francës, që u arsyetua si „çështje e imunitetit të privilegjeve që malësorët mirditas kanë gëzuar gjatë gjithë kohës, e cila në të ardhmen duhet të garantohet“.<sup>1069</sup>

Rreth këtij propozimi reagoi Memed Ali Pasha. Theksoi se nuk mund të flitet për kurrfarë privilegjesh, sepse kjo do të kishte pasoja zingjirore, por që Porta, në kuadër të reformave zotohet se do të ketë parasysh edhe “rastet e veçanta”. Pas një shkëmbimi mendimesh me përfaqësuesin e Anglisë dhe atë të Francës, Sadullah Bej, propozoi një zgjidhje kompromisi sipas të cilës Porta nuk do të ndryshojë statusin e Mirditës, që do të thotë se atyre edhe më tutje u mbesin ato që u quajten „privilegje“, me çka si duket u plotësua ai që në parakushte u quajt koncesion europian ndaj Ruisë dhe Sllavëve të Jugut se në kongres nuk do të bisedohet për kurrfarë autonomie tjetër, pos asaj të Bullgarisë, me arsyetimin se çfarëdo kërkesash të ngjashme, që do të paraqiten, duhet të barten në kuadër të zotimeve të Perandorisë Osmane për reformat e brendshme, që ajo mori përsipër në Kongres.<sup>1070</sup>

Pas pranimit të Serbisë dhe të Malit të Zi si shtete të pavarura, të cilave iu dhanë edhe disa nga tokat shqiptare që i kishin pushtuar gjatë luftës ruso-turke (Serbisë pjesët nga Nishi deri në Kurshumli, ndërsa Malit të Zi Plava, Gucia, Kuçi, Triepshi, Podogorica si dhe Tivari në bregdet), Kongresi i Berlinit, në seancën XIV, më 29 qershor, vuri në rend dite edhe kërkesën e Greqisë për t’u zgjeruar në veri, me ç’rast, ministri i jashtëm grek, T. Deliyannis kërkoi që vendit të tij t’i jipej Kreta, Thesalia dhe Epiri.<sup>1071</sup> Ai propozoi një korigjim të kufirit në vijën e lumenjve të Salamarias (Peneusi i lashtë) – Kallamas duke prerë e shkëputur një thellë të madhe të pjesës shqiptare. Meqë delegacioni osman protestoi si në lidhje me përmbajtjen e kërkesës së ministrit grek, i cili territoret e kërkuara (Thesalinë dhe Epirin) i quante “krahinat greke” dhe në lidhje me vetë pretendimet e papranueshme ndaj një popullate e cila nuk ishte greke, me ndërhyrjen e Salisbury, u vendos që fjalët “krahina greke” të zëvendësohen me “Krahinat kufitare të Mbretërisë së Greqisë”, siç u vendos që Perandoria Osmane dhe Greqia duhej të arrinin një marrëveshje të drejtpërdrejtë në lidhje me korigjimin e kufirit.<sup>1072</sup>

Kështu, pika XXIV e Traktatit të Berlinit u paraqit me këtë përmbajtje: “Në rast se Porta e Lartë dhe Greqia nuk do të jenë të afta të arrijnë një marrëveshje

---

<sup>1069</sup> Buxhovi, Jusuf: “Kongresi i Berlinit 1878”, Prishtinë 2008, protokoll, nr 8, faqe 166.

<sup>1070</sup> Geis, Imanuel, vepra e citur, po aty, faqe 91.

<sup>1071</sup> Shih: Buxhovi, Jusuf: “Kongresi i Berlinit 1878”, Prishtinë 2008, protokoll nr. 9, faqe 178.

<sup>1072</sup> Po aty.

për korrigjimin e kufirit që tregohet në Protokollin e trembëdhjetë të Kongresit të Berlinit, Gjermania, Austro-Hungaria, Franca, Britania e Madhe, Italia dhe Rusia i rezervojnë vetes të drejtën që të ofrojnë ndërmjetësimin e tyre ndërmjet të dy palëve për të lehtësuar bisedimet”.<sup>1073</sup>

Edhe përkundër trajtimit si objekt kusuritjesh, përmendja e kazave shqiptare, e qyteteve që po ashtu në dokumentet e Kongresit quhen shqiptare (si Ulqini, Tivari, por edhe Prokupla, Kurshumlia) si dhe futja e tyre në protokolle me këtë trajtim dhe emërtim, së paku edhe në këtë mënyrë, paraqet një dëshmi të pranisë së etnisë shqiptare si faktor të gjallë dhe të pakapërcyeshëm, dhe kjo për historinë ka rëndësi. Madje, etnia shqiptare si e lidhur, gjeti vend edhe në të gjitha hartat që Kongresi mori në shqyrtim për t’u pasqyruar si e tillë edhe në atë përfundimtare, ku mbi shtrirjen e katër vilajeteve u shënuar *Albanien*.

## KONGRESI I BERLINIT DHE ÇËSHTJA SHQIPTARE

Në Kongresin e Berlinit Shqiptarët nuk patën përfaqësues e as aleatë, që sadopak t’ua mbanin krahun. Kjo kishte të bënte me atë se Porta nuk ua pranonte statusin e kombit. Kjo, ata i privonte nga çfarëdo trajtimi jashtë tretmanit të milletit-osman, ku mbaheshin prej shekujsh. Të ndërgjegjshëm se ndodhen para një situatë tepër domethënëse, kur vendosej edhe për fatin e tyre, krahas organizimit siç ishte Lidhja Shqiptare e Prizrenit, si mekanizëm i parë politiko-shoqëror i tyre me kërkesa nga ato për mbrojtjen e vendit e deri te autonomia në kuadër të Perandorisë Osmane, morën përkushtimin e duhur që t’i drejtohen Kongresit me letra, peticione dhe telegrame, që u dërguan nga të katër anët e botës, ku jetonin për të bërë me dije se realitetet historike, pa marrë parasysh çfarë kishin sjellë (besimet e ndryshme), Shqiptarët kishin mbetur i njëjtë, ndërsa etnia e tyre, si Arnautllëk, ishte pranuar edhe nga Perandoria Osmane. Në këtë mënyrë, mund të thuhet se protestuan më shumë se popujt e tjerë të Ballkanit, të cilët edhe pse kishin përfaqësuesit e vet atje, nuk ishin të sigurt se ç’fat i priste, kur dihej se atje, Fuqitë e Mëdha Europiane, ishin mbledhur për interesat e tyre, të cilat duhet t’u nënshtroheshin të tjerat.<sup>1074</sup>

---

<sup>1073</sup> Po aty.

<sup>1074</sup> Në Arkivin Politik të Ministrisë së Jashtme të Gjermanisë (APMJGJ-PAAD) ruhen rreth njëqind letra, telegrame, memorandume dhe peticione të ndryshme të Shqiptarëve, por edhe të tjerëve, që kanë të bëjnë

Nga telegramet, letrat, protestat dhe memorandumet që iu dërguan Kongresit të Berlinit gjatë zhvillimit të punimeve, por edhe në ato që më vonë iu adresuan Komisionit të Kongresit (punoj gjatë tre vjetëve të ardhshëm në nivel ambasadorësh) dhe përfaqësuesve të tjerë të lartë, kërkesat që dilnin prej tyre mund të klasifikohen:

- a) në ato për mbrojtjen e etnisë në përmasat e shtrirjes së saj dhe
- b) në kërkesa për autonomi brenda Perandorisë Osmane, që do duhej të shtrihet në përputhje me atë etnike, ku bëhej e ditur se, nëse e do puna, për këto të drejta do të shkohet edhe deri te lufta e armatosur.

*a) Kërkesa për mbrojtjen e etnisë në përmasat e shtrirjes së saj*

Kërkesa për mbrojtjen e tërësisë së trojeve shqiptare nuk kishte pse të mos ishte parësore, kur kihen parasysh vendimet e Shën Stefanit dhe gjithë ai terror shtetëror që u parapriu atyre në viset veriore me rastin e pushtimeve nga ushtria serbe, që për qëllim kryesor kishin pastrimin etnik të tyre nga popullata shqiptare, siç e kishte paraparë edhe „*Naçertanja*“ e Garashaninit e vitit 1844, frymën e së cilës do të ruajnë edhe projektet e tjera shtetërore serbe. Andaj, në telegramet dhe letrat që i arritën Kongresit të Berlinit, qysh nga fillimi i punimeve, në shumicën prej tyre protestohet kundër vendimeve të padrejta të Shën Stefanit nga drujtja se Europa mund të vazhdonte të mbetej e padrejtë ndaj çështjes shqiptare, së pari pse përfaqësuesit e tyre nuk ishin ftuar në Kongres, por edhe pse dyshohej se në sajë të propagandës së dendur serbe, greke dhe ruse, Shqiptarët ishin anatemuar si popull që nuk ishte në përputhje me interesat e ardhshme europiane, por me ato të Perandorisë Osmane, pra si pushtues.

Zyrtarisht, telegrami i parë që i arriti Kongresit të Berlinit, është ai i myderriz Daut Efendisë nga Tivari, i shkruar dhe i dërguar ditën e fillimit të punimeve në Berlin. Në ato pak fjalë kërkohet që të mos veprohet siç u veprua me marrëveshjen e Shën Stefanit. “Shpresoj, madhëri, se do të veproni sipas së drejtës së zotit dhe nuk do të na harroni apo të na shitni fare“, shkruante Daut Efendia.<sup>1075</sup>

Telegrami i Daut Efendisë është pa nënshkrime shoqëruese e të shumta, siç veprohet rëndom ato ditë. Është një telegram personal dhe hap librin e gjatë të telegrameve, letrave, protestave nga vende të ndryshme dhe nga popuj të ndryshëm, ndër të cilat të Shqiptarëve janë më të shumtat dhe më të gjatat. Kështu, po

---

me çështjen shqiptare. Pjesa më e madhe e tyre i drejtohen Kongresit dhe personalisht Bizmarkut, pastaj përfaqësuesve të Anglisë, Austro-Hungarisë, Francës dhe Italisë.

<sup>1075</sup> Dokumentet e APMJGJ, Tërkei, kutia 143, dok. nr. 214.

më 13 qershor, përfaqësuesit e Lidhjes Shqiptare nga Shko dra i drejtohen përfaqësuesit anglez në Kongres, lordit Beaconsfield (Disraeli) me një memorandum, në të cilin, veç të tjerash, thuhej:

„Shqipëria, e vetmja ndër vendet e Ballkanit nuk ka përfaqësues në Berlin. Ajo nuk ka qeveri të veten, por po ashtu nuk përfaqësohet as nga pala turke.“

Më tutje në këtë memorandum theksohej:

„Shqiptarët kanë veçoritë e veta kombëtare, tradita të shumta e të pasura dhe gjuhën e vet. Historia jonë e vjetër, por edhe ajo nga Skënderbeu e deri te Marko Boçari, është e bujshme“.<sup>1076</sup>

Shkodranët, pastaj i luten Beaconsfieldit që edhe shteti i tij të veprojë për t'i mbrojtur Shqiptarët, ngase „mbrojtja e tokave shqiptare do ta pengonte depërtimin dhe forcimin e pansllavizmit“, që asokohe Rusia e kishte preokupim kryesor në Ballkan dhe kjo së pari binte ndesh me interesat e Anglisë.

Më 20 qershor Kongresit të Berlinit, nga Shkodra i arriti një telegram, ku njoftohet se është marrë vendimi t'u bihet ndesh marrëveshjeve të Shën Stefanit, por ngjashëm do të veprohet edhe me ato të Berlinit, nëse do të ndiqnin të njëjtën rrugë. Në këtë telegram thuhet:

“Qysh më 16 të këtij muaji patëm nderin madhëri që tubimit të nderuar të Berlinit t'i dërgojmë një letër me dëshirat tona më të sinqerta për suksesin e tubimit. Ne, Shqiptarët myslimanë dhe jomyslimanë të rrethit të Shkodrës vendosëm që për të drejtat tona të mbledhim qindra e qindra nënshkrime dhe që ju ekselencë të njiheni me përmbajtjen para se t'u vijë, atëherë në këtë telegram po ju njoftojmë shkurtimisht rreth përmbajtjes së tij, duke bërë me dije se ne Shqiptarët dëshirojmë ruajtjen e integritetit të tokave tona nën madhërinë e Sulltanit“.

Letra e gjatë e shkodranëve, për të cilën do të bëjnë fjalë në telegramin e tyre të 20 qershorit, Kongresit do t'i arrijë më 27 qershor.<sup>1077</sup>

Kjo letër ka gjithsej 451 nënshkrime dhe në përgjithësi, në këtë drejtim, si peticioni më i madh, shfaqet si unikat i Kongresit. Atë, në faqen e parë e nënshkruajnë myderriz Daut Efendia, pastaj Selino Gurezi dhe Filip Muzani. Ashtu si në telegram, edhe në këtë letër kërkohet mbrojtja e tokave nën përkujdesjen e Portës. Pa u përmendur sulltani, më 21 qershor telegram të ngjashëm Kongresit do t'i drejtojnë edhe përfaqësuesit e Shqipërisë së Jugut nga Janina.<sup>1078</sup>

Në telegram, përpos të tjerash, thuhet:

---

<sup>1076</sup>Po aty, dok.nr. 216.

<sup>1077</sup>Dokumentet e APMJGJ, Türkei, 143, dok. Nr.128

<sup>1078</sup>Po aty.



„Protestojmë rreptësisht kundër copëtimit të tokave tona. Shpresojmë se ju do të tregoheni të vëmendshëm ndaj çështjes sonë“.

Telegrami nënshkruhet nga Mustafa Pasha, Mehmedali Pasha, Abedin Bej, Omer Bej, Xhelal Bej, Hasan Bej, Sabri Bej, Mehemed Bej, Mehmedali Vrioni, Abdyl Frashëri, Osman Tahiri, Muslim Vasini, Xhelosh Osmani, Ali Leskoviku, Sylejman Bej dhe Tefik Bej.

Një telegram tjetër, i cili po ashtu meriton vëmendjen, është ai i 25 qershorit, i cili Kongresit iu dërgua nga përfaqësuesit e Vilajetit të Kosovës. Nënshkruarit e këtij telegrami të gjatë, myftiu Zenel Abedini nga Prishtina, Zija Bej i Gjilanit, Hysen Aga i Gjakovës, Abdurrahim Aga i Pejës, Halil Bej nga Tetova, Zenel Efendia nga Shkupi, Tadea Latini nga Prizreni dhe Hasan Aga nga Vranja, ia bëjnë me dije Kongresit gjendjen e keqe të muhaxhirëve, të përzënë nga Kurshumlia dhe Vranja pas vendimeve të Traktatit të Shën Stefanit:

“Mijëra e mijëra njerëz tanë të pafajshëm u dëbuan dhunshëm nga vatrat e tyre, u trajtuan si kafshë nga pushtuesit. Gra, fëmijë e pleq u hodhën në rrugë dhe u maltretuan si s’bën më keq. Ata tash janë në mëshirën e pamëshirë. Të mbetur nën qiellin e hapur, kanë humbur të gjitha që me shekuj patën. Shumë prej vëllezërve tanë që në çfarëdo mënyre deshën të mbeten në trojet e e tyre, u vranë pamëshirshëm dhe shumë të tjerë u arrestuan dhe nuk dihet fati i tyre. Keni parasysh se tokat tona banohej prej pjesës më të madhe të Shqiptarëve dhe vetëm një pjesë e tyre e vogël janë grekë, bullgarë a latinë dhe tash ne si shumicë duhet të injorohemi për shkak të pakicës. Në emër të drejtësisë dhe njerëzores, në emër të civilizimit kërkojmë përkrahjen dhe mbrojtjen tuaj që të mos mbesim në mëshirën e pamëshirë.”<sup>1079</sup>

Për gjendjen e keqe të muhaxhirëve që gjendeshin në Kosovë qysh pas luftës ruse-turke dhe të luftës serbo-turke të dimrit të atij viti, kur pas depërtimit të ushtrisë serbe në ato pjesë dhunshëm u dëbuan nga trojet e tyre, Kongresit edhe një herë tjetër iu drejtua myftiu Zenel Abedini nga Prishtina, duke tërhequr vërejtjen se fuqitë e mëdha, në mos për tjetër, atëherë për arsye të thjeshta njerëzore, duhej të përkujdeseshin për atë pjesë të madhe të popullatës shqiptare që ishte kthyer në viktimitë lufte, por edhe të traktateve të padrejta, siç ishte ai i Shën Stefanit.

Ngjashëm kërkonin mbrojtje nga Kongresi edhe shumë Shqiptarë, trojet e të cilëve iu dhanë Bullgarisë së madhe pas paqes së Shën Stefanit. Ndër ta duhet dalluar telegramin e Iliaz Pashës dhe të shumë Shqiptarëve të tjerë nga Dibra dhe

---

<sup>1079</sup>Po aty.

Manastiri, të datës 26 qershor të atij viti, të dërguar nga Janina. Pastaj, telegramin e myftiut të Shkupit, të datës 24 qershor. Telegramin e Rustem Pashës që mban datën 20 qershor. Letrën e Mirimon Hotit dhe të shumë Shqiptarëve të tjerë nga Manastiri dhe Dibra si dhe letrën e grupit të Shqiptarëve nga Stambolli, të datës 20 qershor, ku porosi e përbashkët e të gjithave del kërkesa për mos copëtimin e tokave shqiptare.<sup>1080</sup>

Letrave dhe telegrameve me të cilat fillimisht Kongresit i kërkohej mbrojtja e tokave, do t'u shtohen edhe ato që shkonin një hap më tej. Kështu më 16 qershor Kongresit i arriti letra e kapedanit të Mirditës Prenk Bibë Doda, e përcjellë me nënshkrimet e 51 bajraktarëve të kësaj krahinë<sup>1081</sup>, në të cilën nxirret kërkesa për ruajtjen e privilegjeve, e cila do të realizohej brenda një autonomie në përbërje të pushtetit të Portës.<sup>1082</sup>

Nga protokollet e Kongresit mund të shihet se kjo letër, kishte zgjuar vëmendjen e pjesëmarrësve, veçmas nga ana e përfaqësuesve të Austro-Hungarisë dhe atyre të Francës, të cilët në seancën e trembëdhjetë e bënë çështje bisede, por pa ndonjë miratim, pos që do të futet në protokoll, gjë që nuk do të ndodh me kërkesat e tjera të Shqiptarëve për autonomi, siç ishte ajo e Shqiptarëve të Stambollit e 20 qershorit, në të cilën kërkohej autonomia e vilajetit të vetëm shqiptar nga katër sosh nën mbikëqyrjen e Portës, që në njëfarë mënyre kjo nuk do të ishte tjetër veçse një kohë kalimtare, për aq sa faktorit ndërkombëtar të vendosjes do t'i duhej që Perandorinë Osmane ta mbante në Ballkan.<sup>1083</sup>

*b) Kërkesa për autonomi në përbërje të Perandorisë Osmane, në kuadër të një vilajeti shqiptar*

Letra e Shqiptarëve të Stambollit e 20 qershorit, që do t'i dërgohet Kongresit, pa mëdyshje se pas gjithë atyre telegrameve dhe letrave të protestës, të ardhura nga vise të ndryshme, heq përshtypjen se fjala mund të ishte vetëm për pasqyrim mllfesh të shkapërderdhura nga mosekzistimi i një qendre që t'i drejtonte dhe të mbikëqyreshin mbi bazat e një programi me kërkesa të caktuara politike, çfarë ishin ato që më dhjetë qershor kishin dalë në Prizren me rastin e themelimit të Lidhjes Shqiptare, por që si të tilla, nuk kishin arritur gjatë kohës sa mbahej Kongresi i Berlinit, e as më vonë. Pa hyrë në arsytet se pse mungon diçka e tillë kur dihej se Lidhja Shqiptare e Prizrenit kishte filluar punimet tri ditë para

---

<sup>1080</sup>Po aty, dok. Nr.33

<sup>1081</sup>Po aty, dok. Nr. 20

<sup>1082</sup>Po aty.

<sup>1083</sup>Po aty.

Kongresit të Berlinit dhe meqë kjo ka të bëjë me hulumtimin e dokumenteve bazë të vetë Lidhjes (nëse ato si të tilla mund të gjenden) dhe, pa përjashtuar mundësinë që pjesëmarrësit e Kongresit, me anën e burimeve që fuqitë pjesëmarrëse kishin në disponim, po edhe të vetë delegacionit të Portës në Kongres të jenë njoftuar për përgjigjen shqiptare ndaj vendimeve të Shën Stefanit, por edhe të atyre që do të pasonin në Berlin, mund të thuhet se letra e Shqiptarëve të Stambollit, në njëfarë mënyre, do ta bartë porosinë e qëndrimeve të marra në Prizren nga përfaqësuesit e të gjitha trojeve shqiptare. Kështu, në këtë letër, që nënshkruhet nga Pashko Vasa, Omer Vrioni, Omer Shefkui, S. Toptani, Hajredin Tekitani, I. Husmedini, A. Dinoshi dhe G. Samiu, në nëntë faqe, jepet një përshkrim nga e kaluara historike e popullit shqiptar.<sup>1084</sup>

Shqiptarët e Stambollit, me këtë rast, ngaqë e kishin të qartë se Bizmarku kishte ndikim të fortë dhe ishte ai që ruante formulën kryesore të marrëveshjeve të ardhshme, vendosin t'i drejtohen atij, jo vetëm si kryesues, që t'ia shpjegojnë luftën e gjatë shumëshekullore kundër të huajve, që nga Pirroja e deri te Skënderbeu, në mënyrë që të tregohej përkatësia europiane si përcaktim historik dhe ekzistencial, që edhe më tutje mbetej edhe në ato rrethana qëllim kryesor.

“Ne jemi populli më i vjetër i Ballkanit, madhëri. Historia jonë është e bujshme dhe plot e përplot ngjarje dramatike. Ne ishim të vetmit që për një çerekshkulli të vetmuar luftuam kundër Perandorisë Osmane kur ajo ishte në kulmin e fuqisë së vet dhe kur që të gjithë ia kishin frikën si djallit. Dhe sot, ne po harrohemi. Qëllimisht dikush nuk na përfill gjoja se ne kurrë nuk kemi luftuar për pavarësinë tonë.”<sup>1085</sup>

Më tutje Pashko Vasa dhe nënshkruesit e tjerë bëjnë me dije sikurse ishte theksuar edhe në pjesën më të madhe të letrave dhe të telegrameve, se “ Shqiptarët janë një pa dallim feje, që kur është puna e mbrojtjes së atdheut harrojnë përkatësinë fetare. Sepse, feja e vetme për ta është mbrojtja e vatanit. Kjo do të thotë, madhëri, se ne kemi vendosur që tokat tona të mos i japim. Tash për tash *dëshirojmë autonomi nën sundimin e madhërisë së tij sulltanit*, meqë kjo për çastin është zgjidhja më e përshtatshme për ne.”<sup>1086</sup>

Më pas jepen hollësi si do të dukej *autonomia shqiptare* dhe cilat do të ishin territoret që do të përfshinte kjo autonomi, ku përmendeshin katër vilajetet: i Shkodrës, i Kosovës, i Manastirit dhe i Janinës.

---

<sup>1084</sup>Dokumentet e APMJGJ, në listen 8 dhe 9 të telegrameve, numri rendor: 33,34, 35 dhe 40.

<sup>1085</sup>Po aty, nr. 40.

<sup>1086</sup>Po aty.

Në fund të letrës, duke u shprehur besimi se letra do të lexohej prej vetë Bizmarkut me vëmendje të duhur sikur të kishte përpara tërë popullin shqiptar, nënshkruesit edhe një herë theksojnë autonominë nën kurorën e sulltanit dhe gatishmërinë që të hidhej poshtë çdo vendim që Kongresi do të merrte në dëm të Shqiptarëve dhe të çështjes së tyre.

Edhe pse kur bëhet fjalë për letrat, telegramet, memorandumet dhe protestat që iu drejtuan Kongresit, të shumtën e herës të adresuara për kryesuesin, kancelarin gjerman Bizmark, përpos regjistrimit me kujdes që atyre u është bërë në regjistrin kryesor, nga ajo që del nga protokollat, nuk mund të shihet si dhe sa ato u trajtuan drejtpërsëdrejti në seancat kryesore. Përjashtim këtu bën vetëm një pasus nga mbledhja e trembëdhjetë ku shihet se përfaqësuesit i Portës, Karateodori Pasha me rastin e polemikës me përfaqësuesin rus dhe atë grek rreth territoreve që Greqia kërkonte në Epir, përmend peticionet e ardhura nga popullata e atjeshme shqiptare e Janinës dhe e Prevezës duke u thirrur në regjistrin e Kongresit me ç'rast ua thekson numrat e regjistrit nga ai pesëmbëdhjetë deri në njëzet e tre.

Nga burime e kancelarisë mund të kuptohet se Bizmarkut kishte pasur njohuri thujse për të gjitha kërkesat që vinin anash, pra nga letrat, peticionet, memorandumet dhe opinionet, mbasi që shënohet se para fillimit të çdo seance, veç e veç, takohej me përfaqësuesit e delegacioneve, prej të cilëve kërkonte hollësi rreth atyre që si kërkesa, ankesa apo peticione i drejtoheshin Kongresit.<sup>1087</sup>

Kjo, pastaj, dëshmohet edhe me informatat plotësuese që ai kërkonte nga ambasadorët, konsujt dhe burime të tjera diplomatike rreth çështjeve që ai i vlerësonte të rëndësishme, ndër të cilat si e tillë duhet të shikohet edhe njoftimi i ambasadorit gjerman në Stamboll, Hasfield, nga tetori i atij viti, kur ai do të japë sqarime plotësuese rreth autonomisë së Shqiptarëve në përbërje të Perandorisë Osmane, e cila në opinionin e atjeshëm ishte shpallur në shtator të atij viti në gazetën e Sami Frashërit „*Tercuman-i Sark*“. Hasfieldi, në këtë raport, i cili hyn në radhën e atyre që kancelaramti i trajtonte si „të porositur nergut për t'u plotësuar të dhënat e caktuara“, bën të ditur se Shqiptarët, të pakënaqur me vendimet e Kongresit të Berlinit, kanë formuar Komitetin Revolucionar, i cili ka shpallur programin për autonominë, me këto kërkesa:<sup>1088</sup>

1. Bashkimi i vilajeteve shqiptare në një vilajet.

<sup>1087</sup> Shih: Shënimet përcjellëse të kancelarisë gjermane gjatë mbajtjes së Kongresit të Berlinit të arkivuara te dokumentet bazë të Kongresit, kutia 145, dosja nr.3.

<sup>1088</sup> Dokumentet e APMJGJ, Tërkei, 143/23.

2. Në ato vilajete të punësohen nëpunësit që njohin gjuhën shqipe.
3. Dy herë në vit të mbahet mbledhja e kuvendit të asamblesë së vilajetit shqiptar.
4. Gjuha e bisedave të përditshme dhe ajo e shkollave të jetë shqipja, ndërsa turqishtja të përdoret vetëm si gjuhë për të komunikuar me pushtetin qendror në Stamboll.
5. Të themelohet policia e vendit prej njerëzve të vilajetit.

Kërkesat përfundojnë me qëndrimin që kryeqytet i vilajetit autonom shqiptar duhet të shpallet Ohri, ndërsa edhe tatimet do të duhej të mbeteshin në vilajet.<sup>1089</sup>

Hasfieldi në fund njofton se „janë që të gjitha gjasat që Shqiptarët lidhur me propozimet e tilla gëzojnë përkrahjen e autoriteteve qeveritare turke“, duke bërë të ditur se Shqiptarët edhe më tutje do të nxiten të sabotojnë vendimet e Kongresit të Berlinit, sidomos të pikave të diskutueshme.<sup>1090</sup>

Çështja e *autonomisë shqiptare*, si një zgjidhje kalimtare, që do të ishte në interes edhe të evropianëve dhe të interesave të tyre për një Ballkan jashtë ndikimit rus, që do të ishte i pritshëm edhe pas krijimit të shteteve të Sllavëve të Jugut që mendohet se reflektojnë më tepër nga Perëndimi sesa nga Rusia, do të gjejë pasqyrim të dukshëm në disa nga gazetatat e rëndësishme të kohës, të cilat nuk u pajtuan me vendimet e Kongresit të Berlinit që Shqiptarët dhe problematika e tyre të trajtohej ashtu si u trajtua.

“Pse mos t’u jepej atyre autonomia?... Çfarë kanë ata të përbashkët me Orientin kur dihet se janë populli më i vjetër i Ballkanit?”<sup>1091</sup>

Duke u angazhuar për autonominë e Shqiptarëve si zgjidhje e vetme e mundshme me të cilën mund të sigurohet paqja në Ballkan, fuqive të mëdha u bëhet thirrje që kohën e mbetur ta shfrytëzojnë për t’i korrigjuar disa gjëra.

## VENDI DHE RËNDËSIA E LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT

“Lidhja Shqiptare e Prizrenit” (1878-1881) ishte një lëvizje e gjerë, që pati për qëllim mbrojtjen e tërësisë territoriale, ku banonin Shqiptarët, me ç’rast doli në pah edhe kërkesa për autonominë, si formë institucionale e kësaj mbrojtjeje me parashikimin që të ngrihej deri në shkallën e shtetit autonom, në përputhje me

<sup>1089</sup> Po aty.

<sup>1090</sup> Po aty.

<sup>1091</sup> “Hamburgische Correspondenz”, 15 tetor 1878.

zhvillimet e mëtejshme, qofshin ato që lidhen me reformat e brendshme të Perandorisë Osmane, ose të shpërbërjes së saj të plotë, siç do të ndodhë në të vërtetë. Ajo nuk ishte as organizatë e fshehtë e as që veprimtaria e saj ishte klandestine apo revolucionare, por e hapur dhe me program politik, kombëtar jo vetëm për nga përcaktimi, por edhe për nga natyra, meqë kërkoi që Shqiptarët shkallë-shkallë dhe natyrshëm, me anën e një “Shqipërie osmane”, të mbronin qenien e tyre etnike në kuadër të Perandorisë Osmane.

Shpallja e Qeverisë së Përkohshme në fillim të vitit 1881 dhe shtrirja e autoritetit të saj në pjesën më të madhe të Vilajetit të Kosovës dhe në një pjesë të atij të Manastirit, ishte dëshmia më e mirë e këtij përcaktimi. Si e vetmja organizatë patriotike që veproi në kushtet e Krizës Lindore, “Lidhja Shqiptare e Prizrenit”, u identifikua me vetë Lëvizjen Kombëtare Shqiptare.

“Lidhja Shqiptare e Prizrenit” u themelua dhe veproi në një nga çastet më dramatike që kalonte Shqipëria gjatë shekujve të rëndë të sundimit osman, në kohën kur Rusia Cariste me Traktatin e Shën-Stefanit dhe pastaj Fuqitë e Mëdha me vendimet e Kongresit të Berlinit, vendosën t’i copëtonin trojet e Shqiptarëve në dobi të monarkive fqinje duke rrezikuar kështu ekzistencën e tyre si komb. Në këto rrethana dramatike për fatin e Shqipërisë “Lidhja Shqiptare e Prizrenit” mori përsipër detyrën e madhe historike të bashkonte mbarë popullin shqiptar në luftë për të afirmua identitetin kombëtar në arenën ndërkombëtare, për të kundërshtuar copëtimin e trojeve amtare në dobi të shteteve fqinje dhe për të realizuar detyrën madhore të Rilindjes – formimin e shtetit kombëtar shqiptar.”<sup>1092</sup>

Ky objektiv, “Lidhjen Shqiptare të Prizrenit”, si organizatë patriotike shqiptare, doemos se e nxjerr në krye të këtij misioni historik, me çka hudhën poshtë edhe ca nga pikëpamjet ndryshe dhe mohuese madje, me të cilat Lidhja u pa si dorë e djathtë e Perandorisë Osmane, si krijesë “e kurdisur”, që më vonë do të vegjetojë në një drejtim të kundërt, jashtë mbikëqyrjes nga një qendër dhe kryesisht do t’i shërbejë procesit të minimimit të paqes europiane.<sup>1093</sup>

Krijimi dhe evoluimi i “Lidhjes Shqiptare të Prizrenit” nga një organizatë që kërkonte mbrojtjen e atdheut nga copëtimet që i vinin nga të gjitha anët e deri te

---

<sup>1092</sup> Frashëri, Kristo: “Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881”, Tiranë 2012, faqe 702.

<sup>1093</sup> Ndër historianët që Lidhjen e panë krijesë të Portës për qëllime politike, është historiani serb, Gopčević, Spiridon, i promovuar në Vjenë, i cili, me librin “Oberalbanien und seine Liga”, të botuar në Laipzig në vitin 1881, ia doli që të mjeçullojë pamjen e Lidhjes, por jo edhe ta mohojë karakterin e saj në mbrojtje të tokave të veta, të cilin ai e pasqyrooi “si luftë të Shqiptarëve kundër europianëve dhe qytetërimit të tyre për interesat e fundamentalizmit islamik”. Pikëpamje pak a shumë të njëjta ka edhe historiani tjetër serb Hađiva-siljević, (“Arbanaška Liga”, Begrad 1908), i njohur edhe për përkrahjen e dezinformatave për gjoja takimet e Bizmarkut me përfaqësuesit shqiptarë në Berlin (Abdyl Frashërin dhe Mehmet Vrionin në vitin 1879).

(gjë që këtë e bëri me sukses me rastin e mbrojtjes së Plavës dhe të Gucisë, pastaj Grudës dhe Hotit e deri te lufta për Ulqinin), kaloi nëpër disa faza të zhvillimit të saj të përgjithshëm, ku shpeshherë, midis tyre është vështirë të tërhiqen vija të qarta përkufizimi, megjithëqë disa nga historianët gjermanë (Peter Bartel dhe Hans Diter Schanderl) vlerësojnë se në fazën e parë të zhvillimit “Lidhja Shqiptare e Prizrenit” ishte pothuajse në tërësi një organizatë myslimane dhe nuk premtonte diçka përveç se t’u shërbente nevojave të Perandorisë Osmane nga jashtë dhe nga brenda. Barteli thotë se „për Shqiptarët atëbotë ishte tejet e rëndësishme të mbroheshin tokat e tyre dhe për një gjë të tillë mbrojtja e sulltanit ishte më se e nevojshme“.<sup>1094</sup>

Po ky autor për fazën e parë të Lidhjes thotë se nga pikëpamja kohore ajo shtrihet deri në vjeshtën e vitit 1879, kur kryesisht ishte e kthyer për t’i mbrojtur tokat nga Mali i Zi. “Autonomia mezi zihet ngoje po, edhe po qe se përmendet, atëherë bëhet shkarazi dhe pa ndonjë koncept të qartë.”<sup>1095</sup>

Faza e dytë e Lidhjes do të hetohet prej fundit të vitit 1879 e deri në qershor të vitit 1880, kur me anën e një letre me shtatë pika që do t’i dërgohet sulltanit, do të theksohet edhe kërkesa për autonomi. Koha që do të vijë pas qershorit të vitit 1880 dhe ngjarjet e bujshme të vjeshtës dhe të dimrit të këtij vitit do të quhen „me kthesa të forta“, të cilat Lidhjen Shqiptare do ta definojnë si organizëm që kërkon autonomi, kryeqytet, të ardhurat e veta dhe çdo gjë që i duhet një vendi për t’u vetadministruar, duke filluar nga valiu i përgjithshëm, i cili duhet të jetë shqiptar, nëpunësve të vendit e deri te mbikëqyrja e tatimeve.<sup>1096</sup>

Fazë e fundit konsiderohet ajo e konfrontimit të drejtpërdrejtë dhe e luftës së forcave të “Lidhjes Shqiptare” në vitin 1880 me rastin e mbrojtjes së Ulqinit kundër forcave osmane, që më në fund Shqiptarët, në pamundësi që t’i bëjnë ballë një armate të organizuar dhe të pajisur me armatime të shumta, do të tërhiqen dhe Malit të Zi Porta e Lartë do t’ia dorëzojë qytetin në përputhje me detyrimet që i kishte nga vendimet e Kongresit të Berlinit, por që ata pastaj, do të krijojnë Qeverinë e Përkohshme, e cila për disa muaj do të shtrojë autoritetin e vet në vilajetin e Kosovës dhe pjesërisht në atë të Manastirit, prej nga do të dërgohen mesazhet e qarta se Shqiptarët nuk e kanë harruar as shtetin e tyre e as administrimin

---

<sup>1094</sup> Bartl, Peter, vepra e cituar, faqe 187.

<sup>1095</sup> Po aty.

<sup>1096</sup> Po aty.

e tij, i cili filloi si autonom dhe, herdo-kurdo, do të përfundojë me pavarësi kombëtare.<sup>1097</sup>

Bartel vlerëson se “Lidhja Shqiptare” edhe pas disfatës ushtarake të vitit 1881 në njëfarë mënyre vazhdoi të vepronte, por përpjekjet e Shqiptarëve atëherë ishin më shumë të shkëputura dhe pa ndonjë veprim të ndërlidhur në të gjitha vilajetet, siç ndodhte kur ishte e organizuar.<sup>1098</sup>

Hiq dilemën se a ishte Lidhja Shqiptare fillimisht „një lëvizje e pastër myslimane apo jo“, Bartel nxjerr përfundimin se megjithatë „Lidhja Shqiptare e Prizrenit, pa marrë parasysh taktizimeve që iu desh t’i bënte, filloi, vazhdoi dhe përfundoi si një lëvizje nacionale, barrën kryesore të së cilës e bartën Shqiptarët myslimanë, të cilëve iu bashkuan edhe Shqiptarët e besimit katolik të Veriut. E formuar si domosdoshmëri për t’u mbrojtur nga grabitjet e jashtme (mendohet në copëtimin e territoreve), ajo u shndërrua, me kalimin e kohës, në një lëvizje nacionale, e cila kërkoi autonominë e vilajeteve shqiptare nën ombrellën e Portës. Bile, krahu i saj radikal këtë autonomi deshi ta shpinte më tej – deri te pavarësia e plotë“.<sup>1099</sup>

“Tri vjet veprimtarie të Lidhjes shënojnë një faqe të ndritshme dhe të re në historinë e popullit shqiptar“, thotë Shanderl. Ajo në planin ushtarak u tregua homogjene dhe ia doli në krye t’i pengojë ca nga vendimet e Kongresit të Berlinit, sidomos paragrafin XXVIII, me të cilin parashihej që Plava dhe Gusia t’i jepeshin Malit të Zi dhe paragrafin XXXIV, sipas të cilit rekomandohet që edhe Janina dhe Larisa të kalojnë nën sundimin grek.<sup>1100</sup>

Lidhja, pra, mendon ky autor, për herë të parë pas një sundimi të gjatë osman, nxiti në masë të madhe synimet nacionale dhe të lirisë, të cilat do të sendërtohen përfundimisht tridhjetë e katër vjet më vonë, ndonëse jashtë shtetit mbetën dy të tretat e etnisë shqiptare, bashkë me gjysmën e popullatës që u pushtuan nga Serbia, Mali i Zi dhe Greqia gjatë luftërave ballkanike të vitit 1912.

Një qëndrim paksa më të matur në kuptimin e minimizimit të saj rreth përmasave të Lidhjes Shqiptare si lëvizje dhe rezultateve të saj shfaq Georg Stadmüller kur vlerëson se „Lidhja nuk arriti karakterin e një lëvizjeje të madhe p0-

---

<sup>1097</sup> Po aty, faqe 188.

<sup>1098</sup> Po aty, faqe 190.

<sup>1099</sup> Po aty.

<sup>1100</sup> Schanderl, Hans: “*Die Albanienpolitik Österreich-Ungarns und Italien 1877-1908*”, 1950, faqe 124.



pullore, ngase udhëheqësit e saj ishin vazhdimisht të mbërthyer nga ndikime të jashtme, kështu që edhe qëndrimet e tyre nuk mund të ishin unike.<sup>1101</sup>

Çështja e ndikimeve të jashtme, që zihen ngoje, jo vetëm që ishte e pashmangshme në ato rrethana, po ishte edhe e nevojshme madje, sidomos nëse kihet parasysh se që nga fillimet e krizës lindore e Perandoria Osmane detyrimisht, me anën e luftërave që humbte dhe traktateve që pasonin, ishte në tërheqje e sipër dhe se ishte vetëm çështje kohe dhe e koniunkturave ndërkombëtare kur dhe si do të kthehej aty nga kishte ardhur dhe në përputhje me këtë do të tërhiqeshin edhe vijat e konstrukteve të reja, si autonomi të mbikëqyrura apo si shtete, që do të krijonin një mozaik të ri në realitetin ballkanik, gjë e cila edhe kishte ndodhur.

Natyrisht se në këto kushte, Shqiptarët duhej t'u nënshtroheshin ndikimeve të jashtme në një mënyrë të veçantë, meqë gjendeshin brenda për brenda një limiti kur sjelljet e tyre në njërin anë përcaktoheshin nga lojaliteti ndaj Portës, meqë ajo shfaqej si garantuese e mbrojtjes së etnisë së tyre, dhe në tjetrën anë përpiqeshin qënë kuadër të reformave të brendshme të fushin interesat e tyre - siç ndodhi me kërkimin e autonomisë, e cila refuzohej nga Porta e Lartë me pretekstet se kjo nuk lejohej nga kurthi i "miletit-osman", ku shqiptarët mysliman ishin vendos dhe nuk u lejohej statusi i kombësisë. Por, autonomia refuzohej edhe nga jashtë, veçmas nga Rusia, e cila vlerësonte se do të ishte e dëmshme për interesat e tyre në këtë anë nga druajtja se „me anën e saj, një ditë, perëndimorët dhe lindorët, do të binin në ujdi, kundër interesave ruse“.<sup>1102</sup>

Andaj, jo pa arsye, nga korifeu i kësaj propagande që nga koha e Krizës lindore e këndeje, kur Shqiptarët heshtnin, paraqiteshin si „mbrojtës të Turqve në Europë“ dhe kështu njollosoheshin si kundërshtarë të tyre, ndërsa kur luftonin për interesat e tyre që fillimisht lidheshin me statusin e autonomisë brenda Perandorisë, atëherë paditeshin si „prishës të paqes, rrënues të marrëveshjeve dhe të interesave europiane“.<sup>1103</sup>

Siç shihet, kjo hipotekë do t'i ndjekë Shqiptarët gjatë gjithë kohës dhe mund të thuhet se ata që do të përkujdosen më së shumti për të do të jenë shumë nga diplomatët e njohur të Fuqive të Mëdha në Stamboll dhe gjetkë, ndër të cilët gjithsesi se dallohen gjermani Hasfield dhe më vonë Radulin, që fillimisht "Lidhjen Shqiptare të Prizrenit", në raportet, jo rrallë, do ta paraqesin „krijesë osmane“, "kamufli i Portës" e të ngjashme, ndërkohë që më vonë, kur do të marrë

<sup>1101</sup>Stadmüller, Georg: „Volkstumgeschichte“, te „Albanische Forschungen“, faqe 376.

<sup>1102</sup>„Hamburgische Correspondenz“, qershor 1882.

<sup>1103</sup>Po aty.

kahun e luftës me Portën, do të quhet „rrënuese e paqes, rrënuese e marrëveshjeve të Kongresit të Berlinit“.<sup>1104</sup>

Nga kjo pikëpamje del se ambasadori Radulin, që erdhi pas Hasfieldit, do të t'ia kalojë shumëfish atij. Në raportet e shpeshta drejtuar Bizmarkut, Radukin, rëndom zhvlerëson përpjekjet e Shqiptarëve për autonomi, qoftë me pendë qoftë me luftë, duke i paditur se „po punojnë kundër interesave europiane“! Kështu, sipas një raporti, kur tashmë kursi i Shqiptarëve pas të gjitha përpjekjeve që përbrenda Portës të siguronte autonominë, që do të ishte në përputhje edhe me sugjerimet e europianëve për reforma të brendshme politike, ambasadori Radulin qeverisë gjermane i sugjeron se „është në interes të Europës që - përkundër turbullirave të tanishme në Ballkan, të cilat po vijnë si pasojë e kryengritjeve të Shqiptarëve, të Bullgarëve e të Kurcovllehëve - të ruhet sa më shumë Turqia në Europë“.<sup>1105</sup>

Se deri ku mund të shkohet me teza „se kundërshtarët e marrëveshjeve të Kongresit të Berlinit ishin kundërshtarë të interesave strategjike europiane“, mund të shihet edhe nga i njëjti raport, që Radulini ia adreson Bizmarkut, ku njofton se „Shqiptarët po plaçkitin nëpër Ballkan; se janë të papërgjegjshëm; se po i sulmojnë garnizonet turke; se nuk kanë kurrfarë respekti për autoritetet osmane dhe se janë pikërisht ata të cilët më 1878 në Gjakovë vranë Mehmed Ali Pashën dhe nuk çanë kokën për asgjë! Ata tash Perandorisë Osmane mund t'i hyjnë në punë vetëm për të përdorur dhunën kundër Armenëve dhe kombeve të tjera në Lindjen e Azisë që po luftojnë për pavarësi, e që Turqisë kaheër do t'i kishin dalë doresh po të mos ishin oficerët e tmerrshëm Shqiptarë, të cilët, ngado që kalojnë, gur e bar i rrafshojnë përtokë“.<sup>1106</sup>

Edhe pse në këtë raport ka kundërthënie tejet të mëdha, bile edhe aso absurde (anatemimet pse Shqiptarët tregohen “të papërgjegjshëm” kur sulmojnë garnizonet osmane dhe nuk u binden ligjeve të Portës, ndërkohë që po për ata që nuk i binden Portës, thuhet se ndodhen në postet komanduese të armatës turke dhe dërgohen të shtypin lëvizjet për pavarësi kundër armenëve dhe popujve të tjerë), megjithatë bie në sy se vlerësimi i Shqiptarëve me dioptrinë e këtyre diplomatëve gjermanë në Lindje, si dhe veprimtaria e tyre politike, por edhe e kundërvënies, bëhet me një gjuhë, të ngjashme me atë të propagandës sllave!

Kjo tregonte se përkundër prapaskenave që ishin thurur që nga Kongresi i Berlinit dhe që kishin shkaktuar kundërshtim, luftëra dhe thellim të krizës në

---

<sup>1104</sup> Dokumentet e APMJ, raport i ambasadorit gjerman në Stamboll, Turkei, kutia 143, dok. 70.

<sup>1105</sup> Dokumentet e APMJ, Turkei, 143, dok. Nr. 78.

<sup>1106</sup> Po aty.

hapësirën e trajtuar në këtë Kongres, të cilit i ishte parashikuar e kundërta, qëndrimet kishin mbetur të pandryshueshme. Pra që *status quoja* të ngrinte çdo gjë, madje edhe ato lëvizje dhe zhvillime që ishin të papërmbajtshme dhe kjo, sipas Radulinit, duhej të bëhej për hir të Europës, edhe pse dihej se Porta nuk mund të mbahej, e lëre më të forcohej. Çdo zvarritje që bëhej në emër të këtij qëllimi sigurisht se do t'i shkonte për shtati Rusisë dhe përkrahësve të saj në Ballkan, siç do të ndodhë gjatë viteve të ardhshme, kur me përjashtim të Shqipërisë së rrudhur dhe të cunguar, pjesa tjetër do të bjerë plotësisht nën ndikimin e saj, gjë që tri-dhjetë e katër vjet pas revidimeve të vendimeve të Shën Stefanit, ajo do të rikthejë pozicionet e humbura në Kongresin e Berlinit në një masë edhe më të madhe dhe më të favorshme për të.

Në të tilla rrethana, pra, u themelua dhe veproi “Lidhja Shqiptare e Prizrenit” e vitit 1878, e cila kundërshtarë nuk pati vetëm fqinjët gllabërues Sllavët dhe Grekët, të përkrahur drejtpërsëdrejti nga Rusët, që nuk do të reshtin t’ia copëtonin trungun etnik, por kundërshtar pati edhe vetë Perandorinë Osmane, edhe pse në rrethana të tilla hiqej sikur mbronte dhe ndante fatin e Shqiptarëve, po që në të vërtetë me shpërfilljen dhe me injorimin e kërkesave të Shqiptarëve për autonomi, por që ata si “lulja e islamit” t’i paraqesë mbështetës të një projekti që i kishte shkuar koha, përfundimisht humbi rastin e vetëm dhe të fundit të dhënë në Kongresin e Berlinit, që në çfarëdo mënyre të ruajë trashëgiminë e saj në hapësirën europiane, të ndërtuar e të shtrirë mbi pesë shekuj.

Pavarësisht këndvështrimit të jashtëm dhe pamjes së saj në përputhje me sferat e interesit, që nuk ishin në dobi të Shqiptarëve, “Lidhja Shqiptare e Prizrenit” shfaqet si lëvizja e parë dhe më e organizuara për autonominë dhe pavarësinë kombëtare në rrugën e gjatë dhe të mundimshme të popullit shqiptar për pavarësi kombëtare. Me shfaqjen e saj ajo theu dy stereotipe, që kërcënonin të ktheheshin në klishe të përhershme politike. Në njërën anë, atë të Shqiptarëve si pjesë e mileti-osman, gjë që do t’i përjashtonte nga familja e popujve europianë dhe qytetërimi i saj, për të cilin ata kishin merita tepër të mëdha ngaqë si popull antik, ishin themeluesi të tij. Dhe, në tjetrën anë, të përkrahësve dhe mbështetësve të fundit të Perandorisë Osmane në pjesën europiane, së cilës i kishte kaluar koha dhe ishte në shpërbërje e sipër.

## KRIZA E MAQEDONISË, “BESLIDHJA SHQIPTARE” DHE “LIDHJA E PEJËS”

Me kalimin e kohës, kur kriza ballkanike do të thellohet pikërisht nga lëshimet që Perandoria Osmane ua bënte të krishterëve, sidomos Serbëve, Grekëve dhe Bullgarëve gjithnjë në dëm të interesave të shqiptarëve kur u cungohej etnia prej tyre, ndërkohë që një krah i lëvizjes xhonturke do të fillojë të pranojë diçka nga gjuha islamiste për ta ngritur frymën e patriotizmit osman, një pjesë e oficerëve shqiptarë, anëtarë të Komitetit “*Bashkim dhe Përparim*” nëpër degët e qyteteve shqiptare (Manastir, Shkup, Tiranë, Elbasan dhe qytete të tjera), do t’ia imponojnë frymën luftarake lëvizjes në mbrojtje të etnisë shqiptare, duke e ndërlidhur atë me zotimet që kishte Perandoria Osmane për ta mbrojtur veten në çdo cep të saj. Si do të shihet, disa nga oficerët shqiptarë nga radhët e armatës perandorake në Selanik, Manastir dhe Shkup, iu bashkuan çetave shqiptare në jug të vendit, për t’iu kundërvënë veprimtarisë së bandave greke, por edhe atyre bullgare dhe serbe, që terrorizonin Shqiptarët, ndërkohë që ato të ndihmuara nga Serbia, Bullgaria dhe Greqia shtreshin si lëvizje nacional-çlirimtare, veprimtaria e të cilave dihej se kishte për qëllim të destabilizonte vilajetet shqiptare (të Kosovës, të Manastirit dhe të Janinës) në mënyrë që internacionalizimi i tyre t’u shkonte për shtati apetiteve serbe, greke dhe bullgare.

Ky zhvillim është i rëndësishëm të qartësohet paksa, sepse ai shënon shkallën e mëtutjeshme të faktorizimit të Shqiptarëve nga brenda dhe nga jashtë. Nga brenda - pse do të tregohet se mbijetesa e Perandorisë Osmane ishte e lidhur ngushtë me mbrojtjen e etnisë shqiptare nga copëtimet si dhe të pranimit të autonomisë së tyre. Ndërsa nga jashtë - pse ata si mbështetës kryesorë të opozitës xhonturke, do t’i ndihmojnë fitores historike të saj, që për çmim duhej të kishte plotësimin e kërkesave të tyre për autonomi, pra të pranimit të asaj që projektohej si “Shqipëri Osmane”, kërkesë kjo që si do të shihet, do të kthehet në një katalizator të krizës së ardhshme ballkanike të përmasave të mëdha mbi të cilën do të lëvizin dhe madje do të bien thujtë që të gjitha shtyllat e brishta, që kishin mbajtur gjendjen tridhjetë e katër vjeçare të *status quo*-se uropiane.

Faktorizimi si dhe kërkesat për identitet kombëtar dhe autonomi, dhe veçmas, roli vendimtar që do të luajnë në fazën e fundit të regjimit hamidian, mund të thuhet se nxiti provokime të dyanshme ndaj Shqiptarëve. Në njërën anë, nga veprimet e fqinjëve (Serbëve, Grekëve dhe Bullgarëve) të cilët, të shtyrë dhe të mbikëqyrur nga Rusia, do të përpiqen që të përvetësojnë hapësirën e asaj që tashmë nga ana e

tyre perceptohej si “mbetje e trashëgimisë Osmane”, me çka do të pengohej çfarëdo lindje e shtetit shqiptar ( si digë kundër pansllavizmit -siç projektohej nga Austro-Hungaria dhe Anglia). Dhe në tjetrën anë, shqiptarët do të provokohen nga sjellja e Portës së Lartë, e cila jo vetëm që refuzonte kërkesat e tyre sa më shumë që ata shprehnin përcaktimin autonomist, duke dëshiruar të mbetej në kursin e përkrahjes ndërkombëtare dhe të gjoja reformave, të cilat për shënjestër kishin kryesisht qërimin e hesapeve me ta (rrënimi i vetëqeverisjes që gëzonin në shumë pjesë, ku ata ruanin pavarësinë e brendshme e të tjera), vazhdonte të bënte lëshime, të cilat u shkonin për shtati pikërisht vendeve sllave dhe Rusisë, gjë që me këtë flakës i hidhej edhe më shumë vaj dhe projektet për ndërhyrje nga jashtë i bënte të pashmangshme, qoftë kur faktorin shqiptar e theksonte “si lulja e islamit”, qoftë kur refuzonte autonominë shqiptare, siç kërkonin Shqiptarët.

Të kësaj natyre, që do të çojnë tek ashpërsimi i raporteve me Shqiptarët, por edhe te shtimi i pezmit të madh të opozitës xhonturke me çka ajo do të mobilizohej shumanshëm, gjithsesi se do të jenë disa nga ngjarjet në vijim, që krizës do t’i japin përmasa edhe më të mëdha dhe madje gjithëpërfshirëse edhe pse mendohej e kundërta. Kështu, ashpërsimet midis Shqiptarëve dhe Perandorisë Osmane, në njërën anë dhe ato të vendeve ballkanike me Perandorinë Osmane në tjetrën anë, si një kah zingjiror, fillimisht lidhen me dekretin e Sulltan Hamitit të 22 prillit 1896 “*Mbi reformat në Vilajetin e Rumelisë*”, pastaj me luftën turko-greke dhe humbjen e Kretës (1897), për të arritur një shkallë të lartë me marrëveshjen e Myrystegut rreth reformave në Maqedoni (1903), ku Austro-Hungaria dhe Rusia thujse në tërësi do të marrin mandatin e mbikëqyrjes në këtë pjesë, me çka kriza ballkanike do të hyjë në një fazë tepër kritike, që në vend se ta stabilizojë *status quo-n*, ajo do të çojë drejt shpërthimit përfundimtar – tek Lufta e Parë Ballkanike dhe fundi i Perandorisë Osmane.

Dekreti “*Mbi reformat në Vilajetin e Rumelisë*”, i cili nga ana e Sulltan Hamitit arsyetohej se ishte në përputhje me paragrafin 23 të Kongresit të Berlinit që Perandorinë Osmane e detyronte që të zbatonte reformat e brendshme që lidheshin me barazinë e popullatës së krishterë por edhe të rregullimit të çështjeve të tjera që kishin të bënin me qeverisjet vendore në përputhje me kërkesat e etnive të ndryshme, në të vërtetë shkonte në dëm të Shqiptarëve dhe të thellimit të mëtutjeshëm të krizës ballkanike. Sepse, në njërën anë Perandoria Osmane refuzonte kërkesat e tyre për autonomi, të cilat, shikuar nga një këndvështrim i gjerë, po ashtu ishin në përputhje me paragrafin 23 të Kongresit të Berlinit, ndërkohë që merrte parasysh ato të popullatës së krishterë për “barazinë” e tyre siç ishte emërimi i ndihmësvalinjve bullgarë, serbë dhe grekë (në vilajetet e Edrenesë, të Selanikut, të Manas-

tirit dhe të Kosovës). Futja e tyre në këshillat administrativë (mexhliet) e këtyre vilajeteve edhe në pjesët ku nuk kishte fare pjesëtarë të tyre, pastaj plotësimi i policisë dhe xhandarmërisë me të krishterë po të këtyre kombësive, që do të përbënin 10 për qind të efektivitetit të tyre dhe të tjera, që dobësonin pozitën e Shqiptarëve dhe gjithnjë e më tepër forconin ato të pakicave sllave në dëm të Shqiptarëve si popullatë shumicë, e cila me këto masa fitonte mundësi të destabilizonte gjendjen edhe aty ku deri më atëherë nuk kishte pasur gjasa për diç të tillë.

Kështu, shpallja nga Sulltani e reformave të prillit vuri në lëvizje të gjitha forcat politike të shoqërisë shqiptare, duke i bashkuar mes veti edhe ato që deri më dje kishin dallime, nga shkaku se përfshirja e vilajeteve të Manastirit e të Kosovës në zonën e reformave hapte mundësinë reale të shkëputjes së tyre nga vilajetet e tjera shqiptare (i Shkodrës dhe i Janinës) çonin kah krijimi i rrethanave, që atyre t'u pranohej statusi i tokave sllavo-maqedonase jashtë çdo realiteti etnik, i cili ishte në dobi të Shqiptarëve.<sup>1107</sup> Me këtë krijoheshin mundësitë për ndërhyrje të vendeve fqinje në përputhje me planet e tyre të kahershme që t'i kthenin në pre të tyre.

Në këtë ngarendje të hapur të demonstrimit të pretendimeve ndaj tokave shqiptare, siç ishin ato serbe dhe greke të shfaqura qysh në vitin 1844 me “*Naçertanjen*” e Garashaninit dhe “*Megalo idenë*” greke, do t'u shtohen edhe ato bullgare. Njohja e të drejtës së “*Ekzarkatit*” bullgar nga ana e Perandorisë Osmane në vilajetin e Manastirit dhe atë të Selanikut, kishte vu në veprim praninë e propagandës bullgare, e cila përpiqej që të realizonte pretendimet hegjemoniste në këto pjesë. Kështu, siç vepronin Grekët prej kohësh, edhe Bullgarët, me anën e agjentëve të vet, kishin filluar të formonin “çeta çlirimtare”, të cilat gjithnjë e më shumë fusnin shqetësim tek popullata shqiptare, duke shtuar shkallën e pasigurisë.

Shpallja e dekretit “*Mbi reformat në Rumeli*”, Vilajetin e Kosovës e dëmtonte më së shumti, ngase ai përkundër shumicës shqiptare, që shkonte nga 60-90 në të gjitha sanxhaqet, pakicën serbe dhe bullgare, që edhe deri atëherë kishte gëzuar të drejtën e kishës së vet, shkollave amtare dhe përkrahej vazhdimisht nga përkujdesja e Serbisë dhe Rusisë, e kthente në të privilegjuar. Kështu pritej që në këtë vilajet reformat të shiheshin me mosbesim të madh. Kjo bëri që në Vilajetin e Kosovës urdhri për zbatimin e reformave u dha me vonesë, në nëntor 1896, por ndeshi kudo në kundërshtimin e Shqiptarëve (në Prizren, Pejë, Gjakovë, Gjiilan, Shkup etj.), ku krahas refuzimit të tyre, protestat dhe kryengritjet filluan të shoqëroren me kërkesa politike, në të cilat gjithnjë e më shumë kërkoheshin reforma të veçanta për Shqipërinë,

---

<sup>1107</sup> Po aty, faqe 262.

që do t'i siguronin autonominë. Në organizimin e kësaj qëndrese, që në shumë pjesë mori formën e rezistencës së armatosur, u shfaq atdhetari nga Peja, Haxhi Zeka.<sup>1108</sup>

Rezistencës së armatosur ndaj reformave në Rumeli, që do të sjellin dështimin e tyre të plotë, paraprakisht do t'u prijnë protestat e shumta në të gjitha krahinat shqiptare. Ato u shoqëruar me një mbështetje të gjerë në shtypin e kohës dhe në diasporë nga veprimtarët e shqiptarizmit, të cilët tashmë kishin krijuar një “front” mjaft të suksesshëm propagandues. Meqë dukej sheshazi se Perandoria Osmane jo vetëm që nuk ishte në gjendje që të mbronte interesat e Shqiptarëve, e as praninë e saj në pjesën europiane, siç premtonte, por, e shtyrë nga Fuqitë e Mëdha si dhe trysnia e vasalëve të Rusisë në Ballkan, të cilët tashmë kishin shpallur planet e tyre hegjemoniste ndaj etnisë shqiptare, po vepronte për të kundërtën. Kjo kërkonte përgjigjen shqiptare. Të kësaj natyre janë disa nga promemoret që nga ana e atdhetarëve iu dorëzuan Sulltanit dhe qeveritarëve të tjerë të lartë të Portës.

Njëra ndër to, që mbante nënshkrimin e Dervish Himës, dallohet për nga ashpërsia e kritikave që i bëheshin Sulltanit pse nuk mbronte interesat e Shqiptarëve si dhe për nga qartësia e kërkesave që shtroheshin lidhur me interesat e Shqiptarëve, ku viheshin në spikamë ato me të cilat kërkohesh ndalimi i propagandave dhe i shkollave të huaja në Shqipëri, dëbimi i mësuesve të huaj dhe zëvendësimi i tyre me mësues shqiptarë (myslimanë e të krishterë), zhvillimi i arsimit në gjuhën amtare, duke çelur shkollat shqipe, që thuhet se ato do të ndihmonin në konsolidimin e kombit shqiptar, do të mbronin vetëqenien e tij, do të çrrënjoshnin ndikimet e huaja dhe do të çonin në njohjen e kombësisë shqiptare nga Porta e Lartë e nga shtetet e huaja.<sup>1109</sup>

Kërkesa të ngjashme Portës së Lartë do i dërgohen edhe nga qendra të tjera, si ajo e Bukureshtit me nënshkrimin “*Në emër të popullit shqiptar*”, e shkruar me nisim të Ibrahim Temos, Nikolla Naços e Faik Konicës. Ky memorandum, i cili mbështet në nenin 23 të vendimeve të Kongresit të Berlinit kërkoi këto reforma: lirin e gjithë Shqiptarëve të burgosur e të internuar për arsye politike; ndalimin e propagandës shkollorë-kishtarë greke e sllave në Shqipëri; çeljen e shkollave kombëtare shqipe; themelimin e kishës shqiptare, përdorimin e shqipes në kishat greke e sllave.<sup>1110</sup>

I njëjti memorandum, por i zgjeruar edhe me aspektet e historikut të popullit shqiptar si popull i vjetër me rrënjët në Antikë, i hartuar në frëngjisht, iu drejtua në formë peticioni, fuqive të mëdha për të kërkuar mbështetjen dhe mbrojtjen e tyre.

---

<sup>1108</sup> Po aty, faqe 262.

<sup>1109</sup> Po aty, faqe 263.

<sup>1110</sup> Po aty, faqe 263.

Në peticion kërkohej mbështetja e Fuqive të Mëdha për zgjidhjen e çështjes shqiptare duke zbatuar një varg reformash radikale, të cilat do të çonin në formimin e një njësie shtetërore autonome shqiptare. Përmbajtjen themelore të këtij dokumenti e përbente kërkesa e bashkimit të vilajeteve (të Shkodrës, të Kosovës, të Manastirit e të Janinës) në një vilajet të vetëm, me kryeqytet Manastirin, me një guvernator (vali) shqiptar në krye. Aty përcaktohej gjithashtu struktura organizative e vilajetit, ku pranë guvernatorit të përgjithshëm do të funksiononte një Këshill i Pleqve, i përbërë prej 24 anëtarësh (nga 6 për çdo vilajet), myslimanë dhe të krishterë, sipas përbërjes së popullsisë së sanxhaqeve dhe të kazave.<sup>1111</sup>

Krahas peticioneve, memorandumeve dhe letrave të ndryshme që iu dërguan fuqive të mëdha nga pjesë të ndryshme dhe krahas një fushate në shtypin shqiptar të diasporës për t'i mobilizuar që të gjitha forcat drejt përballimit të rrezikut të ri që i kërcënohej Shqiptarëve nga kompromiset që bënte Sulltan Hamiti në dëm të Shqiptarëve, nga shpallja e reformave të Rumelisë, në Shqipëri, veçmas në vilajetin e Kosovës dhe të Manastirit, që kërcënoheshin më shumë nga rreziku i copëtimit për shkak të reformave osmane, u bënë përpjekje për një qëndresë të organizuar të përbashkët kundër ndërhyrjeve të shteteve fqinje dhe Portës së Lartë. Kjo do të arrihej duke themeluar një lidhje të re shqiptare, e cila, sipas shembullit të “Lidhjes së Prizrenit” (1878-1881) do të merrte përsipër këtë detyrë.<sup>1112</sup>

Ai që mori përsipër këtë veprim ishte Haxhi Zeka.<sup>1113</sup> Pejani i palodhshëm u vu në krye të përpjekjeve dhe ia doli që në fund të tetorit 1896 në Prishtinë të mbledhë disa nga krerët e rëndësishme të lëvizjes shqiptare, ku u bë fjalë për masat që duhet ndërmarrë që t'u jepej përgjigje e duhur reformave osmane, të cilat shkonin në dëm të Shqiptarëve dhe në dobi të ekspansionizmit serbo-bullgar në hapësirën e tyre. Po ashtu duhej që refuzimi njëherësh të lidhej edhe me kërkesën për

---

<sup>1111</sup> Ideja e *Këshillit të Pleqve* si një instancë më e lartë, vinte nga Sami Frashëri, i cili në veprën “*Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë*” vlerësoi se Shqipëria nuk duhej të ndiqte modelin monarkik por të përfaqësimit krahinor, ku rol të rëndësishëm do të kishin strukturat e tradicionale të fiseve, bajraqeve dhe bashkësive, të cilat do të funksionalizoheshin në rrethanat e reja.

<sup>1112</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi dytë, Tiranë, 2002, faqe 264.

<sup>1113</sup> *Haxhi Zeka* kishte marrë pjesë në luftën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Qe anëtar i Këshillit Qendror dhe bashkëpunëtor i ngushtë i Sulejman Vokshit. Vijoi përpjekjet për të përmbushur idealet e Lidhjes edhe pas shpër-ndarjes së saj. Për veprimtarinë e vet atdhetare, në vitin 1893 u tërhoq në Stamboll, ku u mbajt në arrest për tre vjet. Kur u lirua u kthye në Shqipëri dhe vazhdoi punën atdhetare, e cila do të kurorëzohet me themelimin e “*Besëlidhjes Shqiptare*” dhe të “*Besëlidhjes së Pejës*”. Gjatë gjithë kohës do të bëjë përpjekje për ringjalljen e lëvizjes në përmasa kombëtare, duke ndërlidhur mbrojtjen e etnisë shqiptare nga grabitjet e fqinjëve me kërkesat për autonomi shqiptare në kuadër të Perandorisë Osmane. Do të vritet në Pejë, më 21 shkurt të vitit 1902. Dorasi ishte kapiteni i xhandarmërisë, Adem Zajmi nga Gjakova. Vlerësohet se vrasja e patriotit shqiptar ishte fryt i një bashkëpunimi midis qarqeve shoviniste serbe dhe të autoriteteve osmane, të cilat, në këto rrethana gjenin gjuhë të përbashkët dhe madje bashkëpunonin mirë e mirë.



autonomi. Ishte pra një si ripërsëritje e qëndrimeve të “Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”, e cila duhej të nxirrte në pah vendosmërinë e Shqiptarëve për t’i mbrojtur trojet e tyre dhe kjo të bëhej me anën e kërkesave për autonomi, të cilat duhej të lidheshin me frymën e reformave si dhe zbatimin e tyre, që Portës së Lartë i dilnin si detyrime nga vendimet e Kongresit të Berlinit dhe veçmas nga paragrafi 23.

Mbështetja në këtë paragraf thuhet se njehet vjet pas shfaqjes së tij, Shqiptarët i ballafaqonte me një absurditet, që frymën e reformave që shkonin në dëm të tyre, siç ishin ato të natyrës së dekretit të ri të Rumelisë ta luftonin, por edhe ta pranonin njëherësh dhe madje të kapeshin për to kur kërkonin autonominë dhe kjo do t’ua vështirësojë gjendjen në raport me Perandorinë Osmane dhe karshi faktorit ndërkombëtar, i cili, zbatimin e reformave nuk e shikonte nga interesat e brendshme të atyre që prekte, por nga e vendosura nga jashtë dhe hesapet e tyre. Në këto rrethana, Shqiptarët në njërin anë do të anatemohej si kundërshtarë të reformave - “*mbrojtës të rendit të vjetër feudal-despotik*”, dhe në tjetrën anë si kundërshtarë të “*barazisë*” së popullatës së krishterë, e cila shkonte në dëm të tyre, nga- që i diskriminonte.

Hipotekën e parë, pra të mbrojtësve me çdo kusht të Perandorisë Osmane, Shqiptarëve do t’ua krijonin vetë Sulltan Hamiti me politikën e tij ndaj tyre, duke bërë përpjekje që t’i instrumentalizojë sa herë që do të ballafaqohet me trysninë e Fuqive të Mëdha që t’u lëshojë pe popujve sllavë dhe Grekëve, siç do të jetë rasti i fundit me pranimin e autonomisë së Kretës, që do të pasojë pas luftës me Grekët dhe me lejin e kishës ortodokse serbe dhe asaj bullgare që të shtrijë veprimtarinë e vet në vilajetin e Kosovës gjegjësisht të Manastirit bashkë me hapjen e shkollave serbe dhe bullgare ndërkohë që Shqiptarëve ato do t’u ndalohen edhe ato privatet të hapura me aq mund. Ndërsa hipoteka e dytë Shqiptarëve, si rëndom, u vinte nga shtetet fqinje (Serbia dhe Greqia), me ç’rast kërkesat e tyre për autonomi, do t’i kualifikojnë si “*kurs islamist i Shqiptarëve*” në mbrojtje të Kalifatit dhe të ngjashme.

Kjo gjendje Shqiptarëve do t’ua vështirësojë punën shumë. Sepse, i detyronte të luftonin në dy drejtime njëherësh, punë kjo që nuk do të jetë e lehtë, meqë nga jashtë dhe të shikuara njëanshëm e të shkëputura - së paku nga këndvështrimi refuzues - dukeshin të besueshme. Kështu, do të jetë edhe këtë herë kur pas shpërthimit të luftës me Greqinë, Perandoria Osmane do të mundohet që protestat e Shqiptarëve në vilajetin e Kosovës, fillimisht në Gjakovë, Pejë dhe më pastaj në Prishtinë dhe pjesët tjera dhe do të kurorëzohen me krijimin e një lidhjeje të re të quajtur “*Besëlidhja Shqiptare*”, t’i paraqesë si “*besnikëri ndaj Sulltanit dhe kalifatit*”.

Me këtë parullë, Sulltan Hamitit i shkoi për dore që të mobilizojë një numër të mirë të Shqiptarëve nga vilajeti i Kosovës dhe ai i Manastirit në luftë kundër Grekëve. Madje, edhe pjesa e parë e manifestit të “*Besëlidhjes shqiptare*”, ku theksohej mbrojtja e territoreve shqiptare nga orvatjet për copëtimin e tyre nga Serbia, Bullgaria, Mali i Zi dhe Greqia, i atribuohen “*besnikërisë së Shqiptarëve për mbrojtjen e tërësisë së Perandorisë Osmane*”.<sup>1114</sup>

Në të vërtetë, te kjo çështje kishte diçka. Sepse, lëvizjet kundër reformave, veçmas ato në Vilajetin e Kosovës dhe të Manastirit, të cilat Shqiptarëve ua rrezikonin etninë nga copëtimet dhe pashmangshëm shfaqeshin edhe kërkesat për autonomi, pa marrë parasysh si dhe sa theksoheshin ato, ndërlidhnin dy çështje tejet të ndjeshme por që kishin rëndësi të madhe: në njërin anë atë që kishte të bënte me besnikërinë ndaj Sulltanit dhe Kalifatit - që doemos kishin frymë konservative (siç dëgjohej gjithnjë e më shumë në Vilajetin e Kosovës dhe atë të Shkodrës) - dhe në tjetrën anë qëndrimin mospajtues me Sulltanin, që nënkuptonte kërkesën për kthimin e parlamentarizmit, që do të thoshte largim nga islamizmi dhe kthim kah osmanizmi modern, që doemos se lidhej me politikën xhonturke.

Ky “ndërlikim” shqiptar gjithsesi kthehej në një ndarje tjetër të brendshme, në një pësjtjellim, që përcaktonte rrymime “për Sulltanin si mbrojtës të vetëm nga fqinjët”, që do të thoshte njëherësh qëndrim kundër Xhonturqve dhe shtetit centralist osman dhe anasjelltas. Këto çështje ndikonin pastaj edhe në qëndrimet politike me pasoja për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, ku rëndom ato bëheshin shkak për përçarje dhe dështime madje, siç do të ndodhë në fund edhe me “*Besëlidhjen shqiptare*”, kur do të mbetet në gjysmë të rrugës nga shkak i ndasive mbi këto baza dhe siç do të ndodhë edhe në shumë raste të tjera për të shkuar edhe deri te Memorandumi i gushtit i vitit 1912.

Që këtë herë t’u ikej disi ndarjeve të tilla, të cilat çonin te dobësimi i frymës së bashkimit, por njëherësh u hapnin rrugën vështirësive të tjera, liderët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare nga radhët e “*Komitetit të Stambollit*”, por edhe nëpër qendrat jashtë (Bukuresht, Sofje, Vjenë, Itali dhe gjetiu), nxituan që vlimeve të Kosovës t’ua bashkëngjisin platformën politike dhe madje, të flasin edhe në emër të tyre, në mënyrë që të parandalohej keqpërdorimi nga ana e Sulltan Hamitit, i cili përherë ishte i gatshëm për punë të tilla dhe bënte çmos që revoltën e Shqiptarëve si dhe kryengritjet në mbrojtje të tokave të tyre dhe për autonomi t’i shfrytëzonte për nevojat e veta kur i duheshin. Kështu, atdhetari Preng Doçi në Vjenë, do t’ia paraqe-

---

<sup>1114</sup>“*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 268.

së qeverisë austro-hungareze një memorandum me kërkesat e “*Besëlidhjes shqiptare*”, duke ruajtur theksin vetëm te kërkesat për autonomi.<sup>1115</sup>

Në këtë vazhdë, “*Komiteti i Stambollit*”, i cili në këtë kohë ishte riorganizuar me emrin “*Komiteti shqiptar*” me në krye Sami Frashërin, në pranverën e vitit 1897, gjithnjë duke iu referuar veprimtarisë së “*Besëlidhjes shqiptare*” të Kosovës, e cila kishte zënë të përhapej në drejtim të Shqipërisë së Mesme dhe në Vilajetin e Manastirit, por pa ndonjë lidhje të brendshme bashkëvepruese, do të dalë me manifestin “*Ç’duan Shqiptarët*”, ku miratohej veprimtaria e “*Besëlidhjes shqiptare*” së cilës njëherësh i caktoheshin kornizat programore dhe ato politike, ndër të cilat ishin ruajtja e tërësisë territoriale të vendit dhe kërkesa për autonomi.<sup>1116</sup>

Por, “*Komiteti i Stambollit*” theksonte njëkohësisht se krahas kësaj ishte e nevojshme të luftohej kundër qeverisë së Sulltanit dhe të ndryshoheshin marrëdhëniet e Shqiptarëve. Kjo ishte shenjë e qartë se drejtuesit e Lëvizjes Kombëtare tashmë kishin filluar të merrnin kurs të qartë kundër politikë së Sulltan Hamitit edhe kur bëhej fjalë për çështje të cilat nënkuptonin bashkërendim me Portën e Lartë, siç ishin ato të natyrës mbrojtëse të vendit dhe të etnisë shqiptare brenda saj. Madje, këtë herë, nuk flitej më me çdo kusht për formulën e autonomisë shqiptare nën ombrellën e Perandorisë Osmane, por shfaqeshin edhe opsionet për shtetin e pavarur shqiptar, nëse Perandoria nuk do të jetë në gjendje që të ruajë praninë e saj në pjesën europiane.

*“Nëse Europa, thuhej në manifest, do të vijojë të respektojë tërësinë e Perandorisë Osmane, atëherë Shqiptarët do të punojnë për të siguruar autonominë e Shqipërisë, për bashkimin e vilajeteve të saj në një vilajet të vetëm autonom, me gjuhën shqipe si gjuhë lokale dhe me një guvernator të përgjithshëm që do të administronte vendin nën kontrollin e një kuvendi kombëtar me funksionarë shqiptarë. Nëse Europa do të vendoste t’i jepej fund Perandorisë Osmane, atëherë Shqipëria duhej të bëhej një shtet i lirë e i pavarur, të shkëputej tërësisht prej saj”.*<sup>1117</sup>

Në të dy variantet ndërtimi i shtetëror i Shqipërisë parashikohej të bëhej sipas parimeve demokratike e të përparuara të kohës. Sami Frashëri dhe atdhetarët etjërë të “*Komitetit të Stambollit*” mendonin se sistemi më i përshtatshëm për Shqipë-

---

<sup>1115</sup> Po aty, faqe 269.

<sup>1116</sup> Po aty, faqe 269.

<sup>1117</sup> Po aty, faqe 269.

rinë do të ishte *republika*, e cila do të ndërtohej në përputhje me kushtet e traditat e vendit.<sup>1118</sup>

Kërkesa e “*Komitetit të Stambollit*” që të luftohej kundër Sulltanit, ishte në përputhje me qëndrimin e patriotëve shqiptarë tashmë të harmonizuar me Lëvizjen Xhonturke, ku shumë prej tyre ishin edhe drejtues të saj, por si do të shihet, ajo nuk do të pranohet në të njëjtën mënyrë në Kosovë nga shkakut se regjimi hamitian kishte shumë përkrahës në radhët e feudalëve dhe strukturave të vjetra fanatike dhe despotike, që tradicionalisht kishin gëzuar privilegje dhe druanin se mund t’i humbin ato. Aleat kishin klerin fanatik islamist, i cili po ashtu kishte dalë me parullën frikësuese se “*Xhonturqit dhe autonomistët Shqiptarë kërkonin shpërbërjen e islamit dhe kthimin e krishterimit*”.

Krahas tyre ishte edhe rryma e atdhetarëve veprimtarë të shqiptarizmit, me rrënjë nga “Lidhja Shqiptare e Prizrenit”, të cilët nuk ishin shkëputur nga përcaktimi i njohur patriotik i saj, sado që ata, krahasuar me mbështetësit e Sulltanit, që kishin ofiqe, poste dhe pasuri, ishin dukshëm më të paktë, por njëherësh edhe të ndjekur dhe të torturuar nga regjimi qysh nga koha e formimit të Qeverisë së Përkohshme që kishte ngritur “Lidhja Shqiptare e Prizrenit” në vitin 1880, e cila për afër një vit kishte shtrirë autoritetin e vet në vilajetin e Kosovës dhe në një pjesë të atij të Manastirit, duke u shfaqur si bërthamë e parë e shtetit shqiptar nga koha e shtetit të Arbrit të Skënderbeut, i cili, po ashtu ishte rrënuar dhunshëm nga pushtimet osmane.

Njëri ndër ta, që vazhdonte këtë përkushtim, pra që mbetej besnik i “Lidhjes Shqiptare të Prizrenit” dhe frymës së saj shtetformuese, që do të duhej të manifestoj fillimisht me një autonomi shqiptare për të shkuar më tej, ishte Haxhi Zeka, i cili pranonte qëndrimet e “Komitetit të Stambollit”, por përballë kishte Riza Kryeziu me shumë përkrahës, besnikë frymës së Sulltanit dhe kalifatit si “mburojë” e Shqiptarëve, ani pse shihej fare qartë, se dekreti rreth reformave në Rumeli i Sulltan Hamitit, po edhe marrëveshja e paqes me Greqinë, ku do të humbej Kreta, ishin në kundërshtim me interesat e Shqiptarëve dhe në dobi të vendeve sllave, fqinjëve të Shqiptarëve, të cilët tashmë pretendonin që me anën e reformave, ato t’i kthenin në pjesë të interesave të tyre dhe kështu hap pas hapi të krijonin “fakte” për pushtimin e tyre. Duket se gjatë luftës turko-greke dallimet midis këtyre rrymave, nuk do të jenë gjithaq pengesë për frymën luftarake të Lëvizjes, meqë, si rëndom në raste të tilla, prioriteti i mbrojtjes së vatanit, mbulonte të tjerat. Madje,

---

<sup>1118</sup> Më gjerësisht rreth organizimit të ardhshëm shtetëror të Shqipërisë shih Sami Frashëri: “*Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhetë*”, Bukuresht, 1899.

me këtë përkushtim një numër i mirë vullnetarësh Shqiptarë morën pjesë në këtë luftë në anën e Perandorisë Osmane dhe i ndihmuan fitores së saj, nga bindja se humbja e Grekëve njëherësh do të thoshte zvogëlim i rrezikut për viset shqiptare të jugut që ishin në shënjestër të pretendimeve hegjemoniste greke.

Pas fitores së Perandorisë Osmane në këtë luftë, e cila ndonëse do të përfundojë me autonominë e Kretës, rryma hamitiane me të shpejtë do t'i kthehet përmbushjes së zotimeve që kishte marrë ndaj Fuqive të Mëdha, të cilat, “si dëshmi” konkrete për këtë kërkonin shuarjen e revoltës së Shqiptarëve kundër zbatimit të reformave në Rumeli, meqë ato acaronin raportet e Portës me vendet sllave Serbinë, Bullgarinë dhe Greqinë.

Përballë kësaj trysnie Porta e Lartë sërish iu kthye strategjisë së qëndrimit të dyfishtë ndaj Shqiptarëve: në njërën anë masave plotësuese ushtarake për ta shtypur revoltën e tyre, pra kur ajo vazhdonte të mos ishte në përputhje me interesat perandorake, dhe në tjetrën anë, të marrjes me të mirë të atyre që ishin në gjendje që nga “kundërshtuesit sipas nevojës” që i shkonin për lalë, të ktheheshin në përkrahës të saj, duke u premtuar shpërblime të ndryshme pa përjashtuar edhe poste të larta siç ishte vepruar edhe me rastin e luftimit të Qeverisë së Përkohshme që kishte dalë nga “Lidhja Shqiptare e Prizrenit” në vitin 1881, kur Ali pashë Gucia, Ilias pashë Dibra e të tjerë kishin marrë poste të larta çastin që kishin nënshkruar deklaratën e Dervish Pashës se hiqnin dorë nga çfarëdo autonomie shqiptare.

Haxhi Zeka, përkundrazi, bënte përpjekje që rezistenca të mos ndalej pa u plotësuar kushtet e parashtruara. Ato lidheshin me autonominë dhe ishin në përputhje të plotë me “Komitetin e Stambollit”. Ndërkohë që krahu i Riza Kryeziut me bashkëmendimtarë orientohej kah Sulltani. Ai do të hyjë në bisedime me misionin që dërgoi Sulltan Hamiti në Kosovë të kryesuar nga Is’han beu i shoqëruar nga disa hoxhallarë, të cilët propagandonin “vendosmërinë e Sulltanit që Shqipëria të mbetej pjesë e Kalifatit” dhe kërcënoheshin, se pa të, me të shpejtë bëheshin pre e fqinjëve dhe Rusisë. Pas disa bisedave me përfaqësuesit e Sulltanit dhe do të pajtohej me ta, Kryeziu ftohet në Stamboll dhe atje pritët nga Sulltan Hamiti. Shprehja e besimit sulltanit u përcoll me emërimin e tij anëtar i Kryesisë së Këshillit të Shtetit, ndërsa anëtarëve të tjerë të misionit iu dhanë grada civile dhe ushtarake, si dhe tituj nderi e dhurata të shumta.<sup>1119</sup>

“Paqësimi” në dukje i lëvizjes në Kosovë, pas pajtimit të një pjese të krerëve të “Besëlidhjes shqiptare” që të ndërpritet veprimtaria e saj, meqë sulltani, siç pro-

---

<sup>1119</sup> “Historia e Popullit Shqiptar”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 273.

pagonin përkrahësit nëpër xhami, do të mbronte tokat shqiptare, nuk do të zgjasë shumë. Porta e Lartë, kishte detyrime ndaj Fuqive të Mëdha, të shuheshin që të gjitha vatrat e krizës në Kosovë dhe gjetiu në vilajetet shqiptare, veçmas aty ku pengoheshin reformat, me anën e të cilave pakicës serbe, asaj bullgare dhe greke u bëheshin lëshime të vazhdueshme dhe këto me refrenin se “*ashtu pengohet destabilizimi i rajonit*”.

Në kohën kur “*Komiteti i Stambollit*” dhe klubet shqiptare jashtë shtonin vepërimtarinë e tyre drejt shtruarjes së kërkesave për autonominë shqiptare dhe bënin thirrje në të katër anët që e gjithë vëmendja e Shqiptarëve të përqendrohej kah kjo, duke arsyetuar se vetëm ajo mund ta ruante paqen dhe stabilitetin në rajon dhe me gjerë siç mund t’ia ruante edhe Perandorisë Osmane praninë në Ballkan, Porta e Lartë doli me një “*Projekt për Shqipërinë*”, me të cilin thuhej se “*shpëtimi i Perandorisë sigurohet vetëm me centralizimin e plotë të pushtetit osman në vilajetet shqiptare*”. Në projektin e “reformave” që valiu i Kosovës, ai i Manastirit si dhe ministri i brendshëm dhe ai i luftës ia paraqitën Portës së Lartë në mars të vitit 1898, kërkoheshin masa shtypëse ushtarake kundër rebelimit si dhe për mbledhjen e taksave. Mareshali Et’hem Pasha, komandant i forcave ushtarake osmane në Kosovë, kërkonte që të ndërmerrej çarmatosja e përgjithshme e Shqiptarëve me arsyetimin se “*armët ishin mjeti kryesor i veprimeve të tyre kryengritëse*”.<sup>1120</sup>

Krahas çarmatosjes së Shqiptarëve, për të penguar parandalimin e formimit të një Shqipërie autonome dhe shkëputjen nga Perandoria Osmane, Tefik Pasha ia kishte dalë që në pjesën europiane të Perandorisë, kryesisht në vilajetet shqiptare, të staciononte një ushtri prej 150 mijë vetash. Kjo edhe një herë tregoi se Sulltan Hamiti i mbetej besnik përcaktimit që çështjes shqiptare t’i jepej përgjigje ushtarake. Me këtë rast, masat shtypëse, kundruall Fuqive të Mëdha justifikoheshin me “zbatimin e reformave”. Ndërsa nga brenda arsyetoheshin veprime të domosdoshme për të parandaluar krijimin e autonomisë shqiptare, apo atë që nga shtetet sllave të Ballkanit dhe Rusia tashmë quhej “*Shqipëri Osmane*”, që duhej luftuar me të gjitha mjetet.

Këto masa jo vetëm që nuk arritën efektet e kërkuara, por thelluan edhe më tutje krizën deri te përmasat rajonale. Ndodhi kështu sepse Shqiptarët vazhduan rezistencën me përpjekjet drejt krijimit të një lidhjeje të re, e cila sipas shembullit të “Lidhjes shqiptare të Prizrenit”, do t’i udhëhiqte Shqiptarët në luftën për mbrojtjen e etnisë së tyre, si e drejtë legjitime përballë rrezikut si dhe krijimin e utonomisë shqiptare.

---

<sup>1120</sup> Po aty, faqe 274.

Shkas për një lëvizje të tillë ishte acarimi i çështjes maqedonase, të shpikur në fund të vitit 1898 dhe në fillim të vitit 1899 nga Rusia në përputhje me interesat e saj në rajon, që u shoqërua me shtimin e ndërhyrjeve të qarqeve drejtuese të Bullgarisë, të Serbisë dhe të Greqisë e të Malit të Zi në pjesën europiane të Perandorisë Osmane. Ngritja e çështjes maqedonase Shqiptarët i provokoi shumanshëm dhe me të drejtë, ngaqë aspiratat e këtyre shteteve në këtë pjesë preknin drejtpërdrejtë hapësirën shqiptare, së cilës, krahas copëtimit nga fqinjët, i kërcënohej edhe parandalimi me çdo kusht i krijimit të shtetit autonom shqiptar, që tashmë kishte filluar të projektohej edhe nga disa fuqi europiane (Austro-Hungaria, Italia dhe Anglia), si një opsion real dhe i pashmangshëm, pa marrë parasysh përmasat e shtrirjes që do të kishte.

Të frikësuara nga mundësia që Shqiptarët bashkë me Xhonturqit do të mund të arrinin që ta rrëzonin nga pushteti regjimin hamitian me çka krijohej një gjendje tjetër nga ajo e sferave të interesit tashmë në formësim e sipër, ku Shqiptarët dhe çështja e tyre si mbështetësit kryesor të lëvizjes xhonturke do të fitonte një dimension të ri me krijimin e Shqipërisë autonome dhe, njëherësh të alarmuara se vendet ballkanike do të mund të hynin në luftë me Perandorinë Osmane mu për këtë çështje, Fuqitë e Mëdha bënë një trysni të përbashkët para Portë së Lartë, për të zbatuar reformat në Maqedoni në përputhje me “Memorandumin e Rumelisë” të parashtruar nga Sulltan Hamiti. Për Fuqitë e Mëdha, zbatimi i këtij memorandum, kishte rëndësi të veçantë, meqë duhej të parandalonte autonominë shqiptare, e cila ishte paralajmëruar me rastin e krijimit të “*Besëlidhjes shqiptare*” në Gjakovë dhe Pejë.

Fillimi i zbatimit të reformave në vilajetet shqiptare, edhe përkundër premtimeve që Porta e Lartë u kishte dhënë Fuqive të Mëdha, sërisht hasi në refuzimin e madh të Shqiptarëve, sidomos kur në disa pjesë të sanxhakut të Dibrës dhe të Ohrit filluan të shfaqeshin çetat e para të komitëve bullgare, të cilave pas pak do t’u bashkohen edhe ato greke në pjesën e Manastirit dhe në Epir. Komitet mbështetëshin nga Sofja dhe Athina dhe kishin për qëllim krijimin e një gjendje pasigurie, e mbi të gjitha të venin në dyshim çfarëdo kërkesë të Shqiptarëve për autonomi. Në ndërkohë do të jenë edhe çetnikët serbë, që do të shfaqen në veri (në rrethinën e Mitrovicës dhe të Pazarit të Ri), me thirrjen e “*rikthimit të Serbisë së Vjetër*”.<sup>1121</sup>

Duke parë se rreziku nga ndërhyrjet e fqinjëve bëhej gjithnjë e më i madh, ndërkohë që Perandoria Osmane vazhdonte me lëshime të tjera ndaj pakicës serbe, bullgare dhe greke duke i kthyer në qytetarë të mbrojtur dhe duke i privilegjuar

---

<sup>1121</sup> Shih Skendi, Stavro: “*Zgjimi kombëtar shqiptar*”, Tiranë, faqe 181-186.

vazhdimisht në dëm të tyre deri në atë masë saqë të krijohej përshtypja se kështu fillonte të jepej një pasqyrë tjetër fare e karakterit të etnisë shekullore shqiptare në dobi të asaj sllavo-ortodokse, Shqiptarët nuk kishin rrugë tjetër pos që të vazhdonin aty ku “kishin pushuar”, pra te ringjallja e “*Besëlidhjes shqiptare*”. Por tash me një përkushtimin që të mos mbeteshin në gjysmë të rrugës dhe të mos i nënshtroheshin trysnisë së qeverisë së Stambollit rreth asaj se çfarë duhej të kërkoheshin dhe të mbrohej, siç ndodhte kur ajo vinte në veprim disa nga feudalët që i mbështeste drejtpërdrejt sulltan Hamiti, me të cilët mbante lidhje tejet të afërta dhe miqësore madje, ani pse disa prej tyre, tashmë kishin filluar të vënin lidhje edhe me Beogradin dhe Cetinën në rast se u rrezikoheshin interesat e tyre nga Xhonturqit, po ku shpesh bisedohej edhe për “luftë të përbashkët”, ku feudalët shqiptarë do të ruanin pronat e tyre edhe pasi që të shkonte Perandoria Osmane.<sup>1122</sup>

Patrioti Haxhi Zeka sërish do të lëvizë nëpër pjesët e ndryshme të vendit për të fituar përkrahjen e të gjitha shtresave shoqërore, në radhë të parë të feudalëve dhe familjeve të mëdha me ndikim, por këtë herë me synimin që përnjëmend të krijohej një lëvizje e gjerë, e cila do të jetë mbrojtëse, dhe njëherësh edhe me kërkesa politike për autonominë shqiptare në përbërje të Perandorisë Osmane.

Fryt i këtyre përpjekjeve ishte thirrja e një Kuvendi, i cili zhvilloi punimet në Pejë më 23-29 janar 1899, e ku morën pjesë përfaqësues të parisë dhe të popullsisë së vilajetit të Kosovës. Midis tyre ishin Halil Hasan pashë Begolli, Myderriz Ismaili, Myderriz Abdullahu, Myfti Salihu, Bajram Curri, Myderriz Mehmet Hamdiu, Mehmet Aqifi, Zenel beu, Ali pashë Draga nga Rozhaja, Ismail Haki pashë Tetova, Abdyl Halimi, Mehmet Sherifi, Myderiz Abdyli, Naxhi Mehmet Sulejmani, Mehmet Sherifi, Mehmet Aqifi, Mehmet Tahiri, Mehmet Murati nga Senica etj.

Në kuvend morën pjesë dhe përfaqësues të veçantë të vilajeteve të Manastirit e të Janinës. Këtu u shpall formimi i lidhjes së re shqiptare, që sipas shembullit të Lidhjes së Prizrenit të vitit 1878, u quajt “Lidhja e Pejës”. Kryetar i Kuvendit dhe i Komitetit drejtues të Lidhjes u zgjodh Haxhi Zeka.<sup>1123</sup>

Shikuar nga dokumentet, që do të nxirren dhe mënyra e punës, “*Lidhja e Pejës*” shfaqej analoge me “Lidhjen Shqiptare të Prizrenit”, sado që asaj i mungonte përfshirja e përfaqësuesve të të katër vilajeteve shqiptare. Kështu, ajo aprovoi një Akt Themelor (*Kararnameja*) prej 11 pikash dhe Aktin e Besës (*Ittifak*) prej 12 pikash. Madje, edhe pikat kryesore: shprehja e besnikërisë së Shqip-

---

<sup>1122</sup> Po aty.

<sup>1123</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 273.



tarëve ndaj Sulltanit dhe besnikëria ndaj fesë islame, ishin identike me ato të “Lidhjes së Prizrenit”, sado që ato ishin moto e pashmangshme, pikërisht mbi to mund të ndërtohej uniteti i brendshëm, ai që kërkohet më së shumti edhe atëherë kur ai dukej i pamundshëm. Po ashtu, në Aktin Themelor (*Kararname*) nuk u përfshinë qëndrimet për autonominë shqiptare e as për ndonjë formë të ngjashme, pos që u përmend çështja e qeverisjes së vendit me nëpunës vendorë.<sup>1124</sup>

Konsulli austriak në Shkodër, Ippen, i cili nga një burim i brendshëm ka përcjellë gjithë zhvillimet, qeverisë së vet i raporton se fjala është për të njëjtin program të “Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”. Ippen njofton se “*në kuvendin e Pejës u vërejt dominimi i frymës islame*“ dhe “*besnikëria ndaj Sulltanit dhe kalifatit*”. Vjena ishte më se e vetëdijshme se ky demonstrim “*ishte i domosdoshëm për t’u arritur pajtimi i brendshëm*”, por që kjo assesi nuk do të thoshte se i përshtatej gjendjes së vërtetë, meqë Shqiptarët e dinin se çfarë mund të bënte sulltani për ta.<sup>1125</sup>

Vlerësimet e Ippenit rreth domosdosë së pajtimit të brendshëm të Shqiptarëve, që edhe këtë herë si emblemë mbrojtëse nxori “*besnikërinë ndaj Sulltanit dhe islamit*”, megjithatë, në një pjesë të opinionit europian, të ndikuar nga propaganda serbe dhe greke, u pranuan jashtë konteksteve politike, mjaftoi që “Lidhja e Pejës” të quhej edhe “*kongres fetar mysliman*”.<sup>1126</sup>

Propaganda e sulltan Hamitit dhe ajo e Beogradit te kjo çështje kishin thuar se gjuhë të përbashkët dhe nuk është për t’u habitur pse suksesi i të dytës në shumë qarqe ishte edhe i garantuar.

Por, do të jetë Faik Konica dhe shkrimi i tij në “*Albania*”, që para opinionit shqiptar dhe atij europian, “Lidhjen e Pejës” do ta paraqesë në një dritë tjetër. Konica e quajti “*një asamble kombëtare, që u mbajt në Shqipëri, ku u diskutua në gjuhën shqipe rreth mjeteve për mbrojtjen e truallit shqiptar, që kishte me të vërtetë një karakter kombëtar dhe do të sillte si rrjedhojë forcimin e idesë së atdheut shqiptar*”.<sup>1127</sup>

Kjo që thoshte Faik Konica, e që në të njëjtën kohë do të shoqërohet edhe nga një thirrje e Dervish Himës me titullin “*Rruga e shpëtimit të atdheut është në Besa-Besën*”,<sup>1128</sup> të botuar në gjuhën turke në mënyrë që ajo të kuptohej nga të

---

<sup>1124</sup> Po aty.

<sup>1125</sup> HHStA: Letër e Ippenit drejtuar Goluchovskit, Shkodër, shkurt 1899. Nr. 21 B.

<sup>1126</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 278.

<sup>1127</sup> F. Konica: “*Memoire sur le mouvement nacional albanais*”, faqe 15-16.

<sup>1128</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 278.

gjitha shtresat shqiptare, në të vërtetë kishte të bënte me domosdonë e bashkimit të brendshëm shqiptar rreth projektit për autonominë shqiptare, e cila si shihej, mbe-tej më shumë parullë e një pjese të Shqiptarëve, se sa kërkesë e tyre unike, nga shkaku i dallimeve, por edhe i përçarjeve që ngriheshin mbi ndasitë tashmë të njo-hura “për” dhe “kundër” besnikërisë ndaj Sulltanit, në të cilat tashmë kishte filluar të investojë shumë edhe Beogradi. Këto ndasi ushqeheshin edhe nga drejtime të tjera dhe kishin filluar të rëndonin Lëvizjen Kombëtare deri aty që ajo në shumë raste të humbte unitetin e brendshëm aq të domosdoshëm për rrethanat.

Arsyet pse ishte kështu, sigurisht se ishin të shumta. Ato nuk duhet parë të lidhura vetëm me pozitën gjeografike që kishte Vilajeti i Kosovës dhe ai i Manastirit (i pari kufizohej me Serbinë dhe i dyti me Bullgarinë dhe Greqinë) si vija konfrontimi me fqinjët sllavë dhe grekë, të cilët qysh në vitin 1844 kishin shpallur projektet e tyre hegjemoniste (Serbia “*Naçertanjen*”, Greqia “*Megali idenë*”, ndërkohë që edhe *Ekzarkati* bullgar nga viti 1870 e tutje u bashkëngjitej me pretendime të ngjashme në pjesën e Maqedonisë). Por ato duhej parë edhe si pjesë e ndeshjes shqiptaro-sllave nga mesjeta e hershme e tutje, veçmas gjatë kohës së Bizantit dhe proceseve të shthurjes së tij, kur do të fillojë mvehtësimi i principatave, që si proces kalonte në rivalitet dhe lufta të ndërsjella, të cilat do të ashpërsohen nga shekujt XII-XIV kur do të marrin fund me pushtimin osman.

Pushtimi osman, ndali luftërat e gjata shqiptaro-sllave gjatë Bizantit, që për pasojë pati stabilizimin e etnisë shqiptare në trojet e veta historike. Kjo gjendje zgjati deri sa Serbia të fitojë autonominë (1830). Nga ajo kohë e këndeje, veçmas nga viti 1844 kur do të shpallet programi nacional serb “*Naçertanja*” e Garashaninit, pjesët shqiptare (Dardania antike e cila nga shekulli XIX e tutje, nën presionin rus do të quhet Kosovë dhe viset veriore të vilajetit të Shkodrës), do t’u ekspozohen veprimeve të vazhdueshme luftarake të vendeve fqinje, Serbisë dhe Malit të Zi dhe pushtimeve të tyre, të cilat ua përlligjën Fuqitë e Mëdha, siç ndodhi në Kongresin e Berlinit, kur Serbisë, krahas pushtimeve të viseve të Toplicës dhe të Kurshumlis nga lufta ruse-turke e vitit 1877/8, iu dhanë edhe disa toka të tjera shqiptare në drejtim të Prokupës dhe Leskovicit.<sup>1129</sup>

Meqë, aspiratat e vendeve fqinje shkonin edhe më tutje dhe kishin për qëllim gllabërimin e gjithë hapësirës etnike shqiptare, Perandoria Osmane, e cila nuk ishte në gjendje që kurdoherë ushtarakisht t’u bënte ballë fronteve që po i hapeshin në pjesën europiane me Serbët, Bullgarët dhe Grekët e përkrahur me të madhe nga

---

<sup>1129</sup> Jagodić, Miloš: “*Naseljevanje Kneževine Srbije 1861-1880*”. Beograd, 2004.

Rusia, e cila nëpërmes shteteve sllavo-ortodokse përpique që të shrinte sa më thellë ndikimin në këtë pjesë, ishte e natyrshme që barra e mbrojtjes “së vatanit” t’u binte Shqiptarëve. Madje, ajo t’u kalohej nën oreolin “e mbrojtjes së Perandorisë, të kalifatit dhe të islamit”, sepse u thuhej se kështu mbronin veten. Këtij përcaktimi, pra i duheshin privilegjet e caktuara, të cilat popullata e vilajeteve “të skajshme” shqiptare tradicionalisht i kishte gëzuar, dhe i duhej edhe forcimi i mëtutjeshëm i frymës konservative dhe islamiste, sepse ajo, në emër të besimit të shenjtë, lidhte edhe më shumë gatishmërinë e mbrojtjes së Perandorisë me atë të vatanit.

Sulltan Hamiti ndërtoi strategjinë e ruajtjes së Perandorisë Osmane në pjesën europiane duke u mbështetur të shumtën mbi faktorin shqiptar si “lulja e islamit”, me ç’rast shtrirjes së tyre etnike, do t’i përcaktohet roli mbrojtës madje edhe i sforcuar jashtë mase.<sup>1130</sup> Kjo do ta shtojë edhe më shumë përkushtimin e fqinjëve të tyre që Shqiptarët t’i luftojnë dyfish: si pengesë për planet e tyre hegjemoniste dhe si mbështetës kryesorë të Perandorisë Osmane.

Ky rol, sado i shikuar nga këndvështrimi i interesave perandorake, do të jetë vendimtar edhe për lindjen e vetëdijes patriotike tek Shqiptarët dhe të atij që do të quhet shqiptarizëm. Në këto rrethana faktori shqiptarizëm do të kanalizohet në dy drejtime:

- si mbrojtës dhe i ndërlidhur me islamizmin dhe osmanizmin edhe në shërbim të forcimit të ndjenjës perandorake, dhe

- si pjesë e ndërgjegjësimit drejt formësimit të identitetit kombëtar dhe shprehjes së tij si shqiptarizëm politik, që për kërkesë kishte autonominë shqiptare në përbërje të Perandorisë Osmane.

Ndaj, ishte edhe e natyrshme që betimit “*din ve devlet*” (unitetit të fesë dhe shtetit)t’i shtohet edhe *vatani*, i cili edhe përkundër kornizës perandorake me islamizmin si fundament, pashmangshëm ia shtonte edhe dimensionin e patriotizmit, i cili nuk mund të përjashtonte atë që Sami Frashëri e quante “*atdhe i veçantë*”, që për Shqiptarët shfaqej Shqipëria.

Mbi këtë parim filloi edhe organizimi i parë i Shqiptarëve në përmasa kombëtare - me “*Lidhjen Shqiptare të Prizrenit*” në vitin 1878.

---

<sup>1130</sup> Shih shpalljen perandorake të Sulltan Hamitit të vitit 1880 drejtuar “*Të gjithë popullit shqiptar*” (*umum Arnavudluk ahalisi*). Në këtë dokument, Sulltani hodhi poshtë kërkesën për një vilajet të vetëm shqiptar (të përbërë nga katër vilajetet) duke e quajtur “ide turbulluese” (*fikr-i fesad*), të mbështetur nga disa individë, për të cilët thotë se për qëllim kanë “të vënë shtetin në rrezik”. “*Një Shqipëri autonome do të shërbente për të dobësuar shtetin otoman dhe për pasojë do t’i linte Shqiptarët të pambrojtur ndaj synimeve grabitqare të fqinjëve*”. Më tutje Shqiptarëve u drejtohet “si baba” i tyre dhe u premtoi mbrojtje dhe përkrahje të plotë.

Sado që në fillim Perandorisë Osmane “Lidhja Shqiptare e Prizrenit” nuk do t’i pengojë për aq sa manifestonte atë që shfaqej si frymë e mbrojtjes së *vatanit perandorak*, megjithatë, në zhvillimet e mëtutjeshme, nuk do ta shohë me sy të miri. Madje do të vijë koha kur edhe do të detyrohet që t’i kundërvihet, nga shkakku se në rrethanat e reja vlerësohej se te Shqiptarët, besnikëria ndaj islamizmit dhe osmanizmit dhe fryma e tyre, qoftë edhe tek strukturat feudale dhe fanatike, mund të mbaheshin në vartësi me patriotizmin dhe kundërvlerën që duhej t’i jepej atij, e që në rastin e dhënë, kishte të bënte me mbrojtjen e etnisë shqiptare nga copëtimet nga fqinjët.

Kjo vartësi, në të vërtetë, do të kthehet në masë kushtëzuese ndaj besnikërisë së hamitizmit në Kosovë dhe në vilajetin e Janinës e më vonë edhe në atë Manastirit, që ndonëse asnjëherë nuk do të kthehet në shkëputje të ashpër, as atëherë kur me në vitin 1908 nga trysnia e Shqiptarëve, Sulltani do të detyrohet të kthejë rendin kushtetues dhe parlamentarizmin, ajo do të sprovohet në përputhje me gatishmërinë për mbrojtjen e etnisë shqiptare nga pushtimet fqinje, por edhe nga lëshimet që do t’u bëheshin popullatës serbe, asaj bullgare dhe greke që nga Reformat e Rumelisë të vitit 1896, kriza e Maqedonisë e deri tek Revolucioni Xhonturk.

Në këtë zhvillim do të shihet se rryma hamitiane ndër shqiptar, sado që do të jetë e fortë, fuqinë e vet do ta humbë në përputhje me lëshimet që i bëheshin popullatës sllavo-ortodokse, zhdëmtimin do ta kërkojë tek shqiptarizmi, i cili besnikërinë ndaj Perandorisë Osmane e kushtëzonte me pranimin si kombësi, shprehjen e identitetit etnik dhe atij kulturor, të cilat duhej të kurorëzoheshin me vetëqeverisje të brendshme ose diç të ngjashme.

Pas shpalljes së reformave në Maqedoni dhe veçmas pas Paqes së Myrsteget të vitit 1903 dhe diktatit austro-hungarez-rus për reformat - me çka në tri vilajetet shqiptare (në atë të Kosovë, të Manastirit dhe pjesërisht në atë të Janinës) Perandorisë Osmane do t’i merren që të gjitha kompetencat në fushat kryesore të shtetit: në polici, gjyqësi dhe arsim - ky ndryshim do të arrijë deri aty sa që në një pikë të caktuar besnikëria ndaj Sulltanit dhe Perandorisë Osmane, edhe nga shtresa feudale dhe fanatike ndër Shqiptarët, të ketë shenjë të barazisë me kërkesën për autonomi.

“*Lidhja e Pejës*” (1899-1900), edhe pse nuk do t’ia dalë që t’i arrijë të gjitha ato që kishte paraparë, megjithatë, ajo shënoi një kthesë të madhe në këtë drejtim, sepse besnikëria ndaj Sulltanit dhe Perandorisë Osmane, sado e madhe që të ketë qenë tek një shtresë e caktuar shoqërore me ndikim, dhe sado që edhe më tutje lidhja e saj do të vazhdojë në saxe të frikës nga ardhmëria e pasigurt, megjithatë do

të kushtëzohet me të drejtën e Shqiptarëve që ta kenë autonominë kulturore dhe politike.

Çastin që Fuqitë e Mëdha do të marrin përsipër zbatimin e reformave në Maqedoni, me ndonjë përjashtim të vogël, shtresa feudale dhe përkrahësit e Sulltan Hamitit, do t'u bashkohen rrymës së shqiptarizmit i cili përkrahte osmanizmin modern dhe autonominë shqiptare në kuadër të Perandorisë Osmane.

Kjo kthesë, për ato rrethana, megjithatë do të ishte e pamundur, pa shfaqjen e *“Lidhjes së Pejës”* dhe rolit të saj të madh mobilizues si dhe sprovës me të cilën do të ballafaqohen që të gjitha shtresat e shoqërisë shqiptare, veçmas ato që shqiptarizmin e lidhnin me besnikërinë ndaj Sulltanit, besnikëri kjo e cila gjithnjë e më shu-më mbetej pa hallkën e baraspeshës që do ta mbante.

## PROGAMI POLITIK I RILINDJES KOMBËTARE

Shfaqja e *“Lidhjes së Pejës”* dhe përpjekjet që Shqiptarët mbi bazën e një platforme të përbashkët kombëtare përfundimisht të tejkalonin ndasitë shumështrësore, duhet parë të ndërlidhura me përhapjen e shkallës së shqiptarizmit tek shtresat e gjëra shoqërore me identitete të ndryshme, të cilat do të ndërgjegjësohen se ndodhen para një sprove ekzistenciale. Kësaj gjithsesi do t'i shërbejë veprimtaria kulturore dhe patriotike e shoqatave, klubeve e mbi të gjitha puna e *“Komitetit të Stambollit”* në të cilin ishin të përfshirë pjesa më e madhe e Rilindasve prej nga ndërlidheshin bashkëveprimet e brendshme dhe ato nga jashtë, sidomos me qendrat patriotike në Bukuresht, Sofje, Kajro, Vjenë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me ato te Italo-Arbëreshëve. *“Komiteti i Stambollit”* tashmë luante një rol tejet të rëndësishëm që shqiptarizmi të ushqejej me vepra letrare në gjuhën shqipe, me tekste shkollore, me gazeta dhe mbështetje tjetër që i duheshin një zgjimi kombëtar, që ai mos të mbështetej vetëm në frikën nga pasojat nga rrëzimi i Perandorisë, por tek planet për ardhmërinë edhe pas saj.

Meqë hamitizmi me lëshimet e bëra fqinjëve të Shqiptarëve kishte filluar të kthehej në një faktor që rrezikonte qenien e tyre, ndërkohë që vazhdonte përcaktimin që fuqinë e Shqiptarëve ta shfrytëzonte për ta ruajtur me çdo kusht praninë osmane në Ballkan, por pa denjuar që shtrirja e tyre etnike të legjitimohej edhe politikisht me anën e pranimit të autonomisë, që do të ishte me rëndësi të dyanshme, Rilindasit kishin nevojë që potencialit të madh kundërshtues të Shqiptarëve, që shprehej me anën e kryengritjeve të ndryshme, shpesh të palidhura sa duhej ose që instrumentalizoheshin nga vetë Sulltani për nevojat e veta, t'i krijohej platforma e

qartë politike, në formën e një kërkesë gjithëpërfshirëse që do të ngrihej në një program nacional.

Në mars të vitit 1899, kur “*Lidhja e Pejës*” vijonte të shtrihej në qytete të tjera të Shqipërisë dhe po përgatitej një kuvend i përgjithshëm i saj, në Bukuresht nga Shoqëria “*Drita*”, pa emrin e autorit, u botua vepra e Sami Frashërit “*Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet?*”, e cila njëherësh shfaqej si program kombëtar, meqë aty jepeshin përgjigje të qarta jo vetëm ndaj qëndrimit politik të Shqiptarëve që duhej të mbanin ndaj Perandorisë Osmane, por edhe për ardhmërinë e tyre si komb, e parë në gjirin e familjes europiane dhe të qytetërimit të saj, me çka mund të thuhet se projekti i kombëtar për një Shqipëri europiane që do të kalonte politikisht nëpërmes Shqipërisë Osmane si krijesë të përkohshme, fitonte përkrahjen më të madhe dhe vendimtare madje, me të cilën do të kalojë Lëvizja Kombëtare deri te faza e Revolucionit Xhonturk dhe përfundimisht ajo e pavarësisë kombëtare.

Samiu e quante formimin e “*Lidhjes së Pejës*” një ngjarje të rëndësishme dhe shprehte besimin e shpresën se Lidhja e re do të arrinte bashkimin e popullit shqiptar dhe do të garantonte tërësinë e trojeve shqiptare.

“*Kjo Lidhje, kjo mbledhje e kjo Besë që po bëhen sot në Shqipëri do të jenë kreu i shpëtimit të Shqipërisë*”.<sup>1131</sup>

Më tutje, duke argumentuar nevojën e shtrirjes së Lidhjes së re në gjithëShqipërinë dhe të bashkimit të të gjithë Shqiptarëve, myslimanë, ortodoksë e katolikë thoshte:

“*Më parë se çdo gjë, Shqiptarët duhet të lidhin Besën të madhe e të përgjithshme në mes tyre e të bëjnë një lidhje e një bashkim, që të pushtojë të tërë Shqipërinë*”.<sup>1132</sup>

Ai, po ashtu, kërkonte nga atdhetarët Shqiptarë që ta shndërronin Lidhjen e re në një qeveri shqiptare, në një organ të përhershëm shtetëror, që “*të jetë gjithnjë e kudo sa t’u jepen Shqiptarëve ato që duan dhe të shpëtojnë Shqipërinë nga rreziku, të qëndrojnë e të mbajnë vent qeverie në Shqipëri se qeveri e Turqve s’është një qeveri për ndërtim, por për prishje*”; prandaj “*Lidhja e Shqiptarëve të zërë vendin e saj*” dhe të plotësojë vetë ose të detyrojë me forcë qeverinë turke të plotësojë kërkesat e lëvizjes shqiptare.<sup>1133</sup>

<sup>1131</sup> Frashëri, Sami: “*Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet?*”, Bukuresht, 1899, faqe 4.

<sup>1132</sup> Po aty, faqe 4.

<sup>1133</sup> Po aty, faqe 5.

Kështu, Samiu përcaktoi edhe strukturën organizative të Lidhjes së re Shqiptare: në çdo sanxhak do të ngrihej një këshill i përhershëm, që do të përbënte organin vendor të Lidhjes, ndërsa në kryeqendrën e saj do të vendosej këshilli i përgjithshëm, që do të mblidhej një herë në vit ose kur të lindte nevoja. Ky do të ishte organi qendror legjislativ i Lidhjes Shqiptare dhe do të nxirrte nga gjiri i tij këshillin e përgjithshëm, i cili do të luante rolin e organit më të lartë ekzekutiv të Lidhjes, te një qeverie shqiptare.<sup>1134</sup>

Platforma e “Lidhjes së re Shqiptare”, që do ta shpallë ideologu kryesor i Rilindjes Kombëtare Sami Frashëri në veprën *“Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet?”* si dhe gatishmëria në rritje e sipër e Shqiptarëve, madje edhe e përkrahësve të Sulltanit nga radhët e feudalëve dhe e parisë, e shtynë Portën e Lartë që të ndalojë thirrjen e Kuvendit të Përgjithshëm të Shqiptarëve, e caktuar të mbahej nëfund të majit 1899, sado që nuk do ta ndalë përcaktimin e tyre për të shkuar në drejtimin e duhur, madje edhe detyrimisht, meqë besimi në Portën e Lartë sa vinte e humbej, ndërkohë që rritej rreziku i gllabërimit të trojeve të tyre nga pushtimet e fqinjëve, gjë që shtronte domosdonë e veprimit të përbashkët mbrojtës të të gjitha forcave pa marrë parasysh orientimet.

Porta e Lartë pra i frikësohej *“Lidhjes së re shqiptare”* me një platformë kombëtare, siç ishte ajo e Samiut, sepse përballë rrethanave kur nuk mund të fshiheshin më zhvillimet që çonin drejt rrënimit të Perandorisë Osmane, ajo u jepte përgjigje të prerë dy çështjeve që si dilema kishin përcjellë Shqiptarët prej kohësh dhe kishin ushqyer hutinë e tyre dhe madje edhe ndasitë mbi të cilat Sulltan Hamiti jo rrallë kishte manipuluar Shqiptarët dhe kryengritjet e tyre:

a) se duhej të luftonin (të vepronin) për t’u shkëputur nga Perandoria Osmane, dhe

b) se duhej të luftonin (të vepronin) për formimin e një shteti të pavarur shqiptar, si rrugë e vetme për shpëtimin e kombit shqiptar e të Shqipërisë nga copëtimi.

Çështja e parë arsyeohej me atë se *“Turqia në Europë jetën e ka fort të shkur-tër. Shqipëria s’ka bërë themel e as ka lëshuar rrënjë në vetëvete; rron në themelet e gremisura të Turqisë e në rrënjë të kalbura të saj. Me të rënët e kësaj stihie të madhe do të bjerë edhe Shqipëria e do të shtypetë nën gërmadhat e rënda të saj...”*<sup>1135</sup>

Në qoftë se Shqipëria do të vazhdonte të mbetej nën Perandorinë Osmane, e ndarë në katër vilajete të zakonshme, pa asnjë të drejtë të veçantë dhe në qoftë se

---

<sup>1134</sup> Po aty, faqe 5.

<sup>1135</sup> Po aty, faqe 6.

Shqiptarët do të vijojnë të durojnë tiraninë turke, nuk do të ngrihen për të kërkuar të drejtat e tyre kombëtare për t'u çliruar nga robëria, ata do të identifikohen me turqit.<sup>1136</sup> Në këtë rast, kur Perandoria Osmane të shembej, Shqipëria mund të trajtohej si një pjesë e trashëgimisë Osmane, si objekt për t'u ndarë ndërmjet monarkive dhe do të gremisej bashkë me këtë Perandori.

Që të tejkaloheshin këto dy rreziqe Samiu theksonte se është e domosdoshme që gjithë Shqiptarët të luftojnë kundër sundimit osman dhe se kjo luftë duhej të kurorëzohej me shkëputjen nga Perandoria Osmane *“që të shpëtojë nga shkatërrimi e nga katastrofa drejtë së cilës po shkon kjo Perandori”*.<sup>1137</sup>

Samiu vlerësonte se shembja e saj duhej ta gjejë Shqipërinë të organizuar në shtet më vete e me qeverinë e vet. Thoshte se *“është detyrë e parë që Shqiptarët të kërkojnë nga Sulltani dhe nga shtetet europiane që Shqipëria të veçohet nga trungu turk, që një orë e më parë të ndahet Shqipëria e të dihetë që ku e gjer ku është. Të njihet vendi ynë për Shqipëri, ta njohë Europa për Shqipëri”*.<sup>1138</sup>

Edhe çështja, që kishte të bënte me formimin e një qeverie autonome brenda Perandorisë Osmane, arsyetohej me mundësinë e shkëputjes, si diçka që ishte e pamshangshme.

*“Kjo qeveri shqiptare të jetë sot për sot nën Turqinë, por me një mënyrë që në rëntë Turqia, të mundënjë Shqipëria sikundër që është të qëndrojnë më vehte”*.<sup>1139</sup>

Si çështjen e parë e edhe të dytën, Samiu i shihte të arritshme në rrugë politike, por edhe me ndihmën e luftës.

*“Shqiptarët duhet t'i marrin ato që duan me pahir, t'i kërkojnë me fjalë, po të kenë edhe pushkën plot”,* thotë ai. *“Turqia me dashuri e mirës s'jep gjë kurrë... Shqiptarët janë të zotët t'i ruajnë dhe t'i kërkojnë të drejtat e tyre edhe me armë në dorë. Kur përzihet e drejta me fuqinë, merr një forcë të cilës gjë s'i rri dot kundrejt”*<sup>1140</sup>

Duke mos përjashtuar edhe luftën dhe mjetet e saj - por që ato përherë duhej të drejtoheshin nga penda, pra nga programet intelektuale dhe politike dhe të udhëhiqeshin prej tyre – Samiu pjesërisht heq dorë nga qëndrimi evolutiv të cilin do ta mbrojë vite më parë dhe këtë do ta shprehë edhe në një letërkëmbim me Jeronim De Radën.<sup>1141</sup>

<sup>1136</sup> *“Historia e popullit shqiptar”*, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 291.

<sup>1137</sup> Frashëri, Sami: *“Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet?”*, Bukuresht, 1899, faqe 34.

<sup>1138</sup> Po aty, faqe 35.

<sup>1139</sup> Po aty, faqe 35.

<sup>1140</sup> Po aty, faqe 36.

<sup>1141</sup> Shih letërkëmbimin e Sami Frashërit me Jeronim de Radën te *“Buletini për Shkencat Shoqërore”*, II, Tiranë, 1954, faqe 114-118.



Kur jemi tek letërkëmbimi me De Radën, gjithsesi se vlen të theksohet një përgjigje që Samiu do t'ia japë shkrimtarit të madh arbëresh në vitin 1881 me rastin e rekomandimit të tij që Shqipëria, të organizohej si shtet konfederativ, i ndarë në tri njësi sipas besimeve, plan ky që për Samiun nuk ishte as i mirë e as i realizueshëm. Në radhë të parë Samiu mendonte se Shqiptarët nuk duan të jenë të ndarë por të bashkuar edhe më shumë. Së dyti, Shqipëria nuk ishte ndarë sipas fesë, edhe Shqiptarët e feve të ndryshme nuk rronin në vise të ndara por të përziera me njëra-tjetrën, me përjashtim të jugut ku nuk kishte katolikë. Kishte fise që përbëheshin nga të krishterë dhe myslimanë dhe një i krishterë e ndiente veten më të afërt me një mysliman të të njëjtit fis se sa me një të krishterë të një origjine tjetër.

“Me gjithë përpjekjet e të huajve, të Turqve, Grekëve dhe Sllavëve, për t’i përçarë Shqiptarët, vëllazëria midis tyre nuk ishte prishur, shkruante Samiu. Andaj, çdo ndarje midis Shqiptarëve për shkak të fesë nuk duhej lejuar”.<sup>1142</sup>

Çështja e besimit si dhe ndërlukshmëria e saj, në veprën “*Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhetë?*” po ashtu do të preket me të njëjtën përgjegjësi dhe gjithnjë në vazhden e qëndrimit se feja nuk i ndante Shqiptarët, dhe se vetë prania e tri besimeve, brenda tyre, këtë e dëshmonte më së miri.

“*Fetë duhej t’i liheshin kishës dhe xhamisë dhe se të gjithë Shqiptarët duhej të bëheshin vëllezër ashtu siç e kishte caktuar natyra dhe siç kishin qenë që në kohët e lashta*”.<sup>1143</sup>

Në këtë mënyrë Samiu, i jep përgjigjen më të mirë njëres ndër çështjeve që Shqiptarëve do t’u kthehet në vështirësi më shumë nga jashtë se nga brenda, veçmas kur kërkohet që të shiheshin të shkapërderdhur mbi baza fetare dhe jo të bashkuar mbi baza të identitetit kombëtar, që siç qëndronte mbi atë fetarin dhe këtë do ta dëshmojë më së miri Rilindja Kombëtare kur shqiptarizmi do të shpallët fe e Shqiptarëve.

Shfaqja e veprës “*Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhetë?*” ndonëse në botimin e parë të Bukureshtit do të dalë pa emër, por shumë shpejt do të merret vesh se vinte e shkruar nga Sami Frashëri, atdhetari, shkrimtari, filozofi dhe filologu osman dhe shqiptar ndër më të mëdhenjtë e kohës, ndërkohë që në ribotim dhe në përkthimin në gjermanisht do të dalë me emrin e tij.<sup>1144</sup>

Qeveria Osmane e futi në arrest shtëpiak dhe e mbajti nën mbikëqyrje të vazhdueshme. Nuk i bëri proces gjyqësor pse kishte frikë se një autoritet i përmasave të

<sup>1142</sup> Skëndi, Stavro: “*Zgjimi kombëtar shqiptar*”, Tiranë, 2000, faqe 160.

<sup>1143</sup> “*Buletini për Shkenecat Shoqërore*”, II, Tiranë, 1954, faqe 114-118.

<sup>1144</sup> Sami, Semsettin: “*Was war Albanien, was ist es, was wird werden*”, Vjenë, 1913.

mëdha osmane dhe shqiptare çfarë ishte Samiu, pikërisht ai që ishte aq i merituar për gjuhën turke dhe nacionalizmin osman si dhe për urat lidhëse midis popujve të Perandorisë Osmane dhe islamizmit si forcë që i kishte mbajtur ato, çështjes shqiptare do t'ia jepte përmasat e një rëndësie mbi të cilën varej e ardhmja e Perandorisë Osmane - po qe se do të pranonte formimin e Shqipërisë Osmane, ose shembja e saj - po qe se do ta refuzonte atë.

Samiu Frashëri vdiq pas katër vitesh (1904), i izoluar dhe i mbyllur, por vepra dhe idetë e tij do të gjejnë rrugët e depërtimit ngado që shtrihej bota shqiptare. Ajo u bë udhërrëfyes i njërit ndër projekteve më madhore të mendësisë shqiptare të të gjitha kohëve, duke ushqyer vetëdijen e saj kombëtare me ide dhe vizione me të cilën Shqiptarët do ta gjejnë rrugën e tyre drejt bashkimit dhe pavarësisë kombëtare.

Perandoria Osmane, dhe personalisht Sulltan Hamiti, i dinin qëndrimet e mëhershme të Sami Frashërit të shfaqura qoftë në *"Fjalorin e fjalëve enciklopedike"*, *"Kamusal-Al'am"* (1889-99) në gjashtë vëllime, *"Qytetërimin islamist"* (*Medendieyet-i Islamiyye*), *"Qenia njerëzore"* (*Insan*), *"Gratë"* (*Kadinlar*), *"Fjalorin turk"* në dy vëllime, dhe vepra të tjera, ku ai si gjuhëtar dhe shkencëtar i një formati të lartë, krahas shprehjes së qëndrimit për qytetërimin osman, islamin dhe për qytetërimin në përgjithësi, po ashtu shprehu edhe qëndrimin për Shqiptarët si popull dhe lashtësinë e tyre historike, duke e parë atë pjesë të qytetërimin perëndimor, por gjithnjë duke vënë në spikamë edhe karakterin e lidhjeve historike me lindjen, veçmas me islamin si dhe pasojat, të cilat ai i sheh në kuptimin pozitiv. Duke e trajtuar historinë e Shqiptarëve nga ky këndvështrim, si turkolog dhe osmanist njëherësh, Sami Frashëri krijoi platformën e nxjerrjes së Shqiptarëve nga trajtimi i *milleti-osman*, ku mbahej dhunshëm prej shekujsh, për ta bartur te kombi i pavarur (*kavma*), i cili duhej të pranohej edhe politikisht si i tillë të gëzonte të drejtën e autonomisë.

Nga ky këndvështrim, Samiu u mundua që shqiptarizmin dhe islamizmin t'ishohtë në një vijë pajtuese dhe bashkëvepruese madje në rrethanat kur uniteti i fesë me shtetin nuk pengonte pluralizmin kulturor, ase atë etnik, por i shërbenin kornizës së përbashkët shtetërore. Si ithtarë i islamizmit Samiu pranonte meritat e islamit dhe rolin e tij, por njëherësh mbronte edhe identitetin kombëtar, i cili qëndronte mbi atë fetar.

*"Shqiptari edhe si besimtar mysliman mbetet Shqiptarë, siç mbetet i tillë edhe si i krishterë"*.<sup>1145</sup>

Ky do të jetë qartësimi më i mëdha që do të bëhet rreth vlerësimit midis identitetit kombëtar dhe atij fetar, qartësim ky që do t'i shërbejë shqiptarizmit jo vetëm

---

<sup>1145</sup> Frashëri, Sami: *"Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet?"*, Bukuresht, 1899, faqe 35.

që të vihet në binarët e një rreshtimi historik, por që të krijojë edhe platformën politike në rrethana tejet të ndërlikuara kur Shqiptarëve u mohohet drejta e identitetit kulturor dhe kombëtar e me këtë edhe e drejta për vetëqeverisje mbi këto baza, siç u njihje popujve të tjerë jomyslimanë.

Puna e Samiut në këtë drejtim ishte madhore, sepse doli që shqiptarizmin ta afirmojë duke mos e konfrontuar me islamizmin dhe osmanizmin, por duke e veçuar si “*identitet të veçantë*” në kuadër të identitetit që e quan “*të përbashkët*” dhe ai lidhej me *vatanin* perandorak, një si formulë bashkuese për rrethanat, e cila Shqiptarëve mund t’u shërbente që ta ndërlidhnin identitetin kulturor dhe atë etnik me atë politik pa i konfrontuar me atë fetar, ku ata shfaqeshin të ndarë si myslimanë dhe të krishterë dhe besimi në këtë drejtim merrej si përcaktues madje.

Me dramën “*Besa*” dhe me shumë e shumë shkrime publicistike të botuara në gazetën turke “*Tercümen-i Hakikat*” (*Interpretuesi i të vërtetës*) dhe ato që do t’i drejtojnë vetë në gjuhën turke dhe shqipe, ai për herë të parë do ta nxjerrë edhe *kontekstin shqiptar* brenda për brenda atij perandorak duke shpjeguar qartë raportet midis *shtetit* dhe *kombit* (*dovlet ve millet*) si dhe ndërlidhjet e tyre.

Në gazetën “*Tercümen-i Hakikat*”, qysh në dhjetor të vitit 1878, do të identifikohet me dikë për të cilin “*Shqipëria (është) vatani im i veçantë*” për ta arsyetuar këtë me thënien se “*Për njeriun asgjë nuk qëndron më lartë sesa mëmëdheu (vatani) dhe raca (cinsiyet)*”.

Në gazetën “*Sabah*”, duke replikuar rreth asaj se fjala “*mysliman*” dhe fjala “*shqiptar*” nuk ishin sinonime, meqenëse të gjithë Shqiptarët nuk ishin myslimanë dhe jo të gjithë myslimanët ishin Shqiptarë, do të thotë se “*nëse feja ka një ndikim të madh, mbi të gjitha në Lindje, raca është më e rëndësishme se sa feja*”, për të shtuar pastaj se “*për sa i përket termit ‘shqiptar’, ai nuk është vetëm një pjesë e terminologjisë së gjeografisë moderne, por ka gjithashtu edhe një rëndësi të madhe për Perandorinë Osmane*”.<sup>1146</sup>

Në përputhje me këto qëndrime dhe të ngjashme që do t’i shprehë në shtypin e kohës në gjuhën turke, Samiu do të përpiqet që Shqiptarët t’i ruajnë urat me osmanizmin, sepse ishte i vetëdijshëm se atyre edhe për një kohë u duhej Perandoria Osmane, siç do t’i duhej edhe asaj një Shqipëri (osmane) autonome.

Kohën kalimtare ai e shihte si të dobishme veçmas për Shqiptarët, të cilët, kthesat e kohës, duhej t’i shfrytëzonin që të qartësoheshin nga pikëpamja identitare nga brenda, por edhe në raport me të tjerët, veçmas me islamizmin dhe osmaniz-

---

<sup>1146</sup> Clayer, Nathalie: “*Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*”, Tiranë, 2009, faqe 253.

min. Andaj, në shkrimet e tij të kohës kur do të vihet në krye të “Komitetit të Stambollit” (vitet 1879-1889), gjithnjë duke dashur që Shqiptarët nëpërmes vetëdijesimit shoqëror të arrijnë shkallën e një pjekurie politike për të gjetur një gjuhë të përbashkët me Perandorinë Osmane, për Shqiptarët do të kërkojë autonomi të brendshme, e cila do të ishte në përputhje me shtrirjen e tyre etnike dhe kulturore.

Po në këto shkrime, Samiu kërkonte maturi nga Shqiptarët dhe sjellje të përgjegjshme, meqë nga fqinjët (Serbët dhe Grekët) njëherësh u vinin dy rreziqe: ai ushtarak dhe kulturor, të cilat njëherësh ishin edhe rrezik për Perandorinë Osmane. Kështu që autonominë shqiptare në përbërje të Perandorisë Osmane u mundua ta shpjegonte edhe si interes osman, meqë përbënte një shtyllë mbështetëse për sundimin osman në Ballkan, siç u mundua që edhe emancipimin kulturor të Shqiptarëve ta shihte si interes perandorak, meqë vetëm ashtu Shqiptarët do të jenë në gjendje që t’u japin përgjigjet e duhura sllavizmit dhe helenizmit, të cilat në saje të mbetjes së një pjese të mirë të Shqiptarëve jashtë arsimit kombëtar, kishin filluar t’i asimilimin ata (mendohej tek Shqiptarët e besimit ortodoks dhe ata katolikë) dhe mbi këtë bazë të ngrehnin edhe pretendimet hegjemoniste mbi etninë shqiptare.

Megjithatë, Sami Frashëri te “*Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhetë?*”, që për shumëçka shfaqej si program kombëtar, krahas largimit nga pikëpamjet e mëparshme, të cilat në njëfarë mënyre kërkonin bashkëveprim me Perandorinë Osmane – dhe kjo mund të shpjegohej me shpresën e Samiut se Sulltan Hamiti, përkrahës i të cilit ishte në fillim, do të ndryshonte politikën ndaj Shqiptarëve duke i pranuar si komb dhe duke ua dhënë autonominë, pra që të hiqej dorë prej saj, pse ajo nuk e kishte më jetën e gjatë - do të kërkojë që në rast nevojë të veprohej por edhe të luftohej në mënyrë që Shqipëria të mos trajtohej si pjesë e trashëgimisë osmane, sepse ashtu do të gllabërohej bashkë me të. Me këtë rast ai Shqiptarëve dhe Shqipërisë ua tregonte vendin kah Europa dhe qytetërimi perëndimor. Jo rastësisht, madje ai thotë se duhet bërë çmos që Europa ta njohë, ta kuptojë Shqipërinë në mënyrë që ta pranojë.<sup>1147</sup>

Në të vërtetë, shikimin kah Europa kur Perandoria Osmane i kishte ditët e numërua, tashmë e kishin edhe shumë Shqiptarë që arsimoheshin brenda dhe jashtë vendit, veçmas ata që studionin nëpër qytetet e mëdha europiane, të cilët pashmangshëm binin në kontakt me shqiptarizmin, i cili në mënyra të ndryshme, që nga shoqatat shqiptare, klubet e deri te gazetatat, tashmë ishte i pranishëm në Vjenë, Bruksel, Romë dhe Paris. Por, për Shqiptarët e besimit mysliman, që shqiptarizmin

---

<sup>1147</sup>Frashëri, Sami: “*Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhetë?*”, Bukuresht, 1899, faqe 35.

e kishin përqafuar me të madhe, identiteti europian lidhej me synimin e tyre që të legjitimonin qëndrimin në trevat e tyre kur Perandoria Osmane do të detyrohej të tërhiqej nga Ballkani.<sup>1148</sup>

Kështu, “*Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet?*” kërkimit të identitetit europian i jepte një shtysë të veçantë dhe do të ndikojë drejtpërdrejtë tek transformimi i nacionalizmit shqiptar që të kalojë nga faza e mobilizimit të brendshëm identitar, tek programet politike me një platformë të qartë mbi bazën e kërkesës së krijimit të shtetit autonom shqiptar (si i përkohshëm) dhe të shkëputjes nga Perandoria Osmane.

Nëse mund të thuhet se Sami Frashëri me veprën “*Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet?*”, si ideolog, nacionalizmit shqiptar do t’ia japë platformën më të fuqishme programore mbi të cilën do të mbështetet ai. Megjithatë do të jetë diplomati dhe politikani Ismail Qemali, ai i cili atë do ta dizajnojë nga pikëpamja diplomatike dhe politike deri tek përmasat e jetësimit praktik, të shumtën duke u sjellë në përputhje me ngjarjet dhe zhvillimet duke i shfrytëzuar ato. Andaj, nuk është e rastit, pse historia do ta ngarkojë me përgjegjësinë e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë në rrethana të turbullta dhe po aq të rrezikshme kur edhe luhatja më e vogël do të kishte pasojat tragjike për Shqiptarët.

Ismail Qemali, si shumë e shumë Shqiptarë të tjerë që do t’i bashkohen shqiptarizmit dhe do t’i mbesin besnikë përgjithmonë, edhe në rrethanat kur detyrohehin të bënin kompromise të mëdha dhe të dhimbshme madje, i takonte elitës intelektuale që vinte nga shtesa aristokrate shqiptare e kyçur në radhët e hierarkisë së lartë të shtetit osman. I lindur në Vlorë më 24 maj 1844 në familjen e Sinanajve, që njihej si pronare e madhe e tokave, pasi kreu shkollën fillore në vendlindje dhe gjimnazin “Zosimea” të Janinës, në vitin 1859 u vendos në Stamboll. Këtu hyri si përkthyes në Ministrinë e Punëve të Jashtme, duke ndjekur njëkohësisht studimet e larta për drejtësi.<sup>1149</sup> Më pastaj do të fillojë karriera e tij e gjatë si politikan, cili do të marrë pjesë në të gjitha thyerjet dhe kthesat nëpër të cilët do të kalojë Perandoria Osmane që nga parlamentarizmi, suprimimi i tij nga Sulltan Hamiti, Revolucioni Xhonturk e deri te luftërat ballkanike, të cilat do të përfundojnë me disfatën ushtarake të saj, por edhe me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë.

---

<sup>1148</sup> Po aty.

<sup>1149</sup> Më gjerësisht rreth jetës dhe veprës së Ismail Qemalit si dhe veprimtarinë e tij diplomatike, politike në shërbim të Perandorisë Osmane si dhe veprimtarinë patriotike në dobi të shqiptarizmit, shih “*The Memoirs of Ismail Kemal Bey*”, Londër 1920, të botuar në gjuhën shqipe si “*Kujtime*”, Tiranë, 1997.

Megjithatë, karriera e tij e gjatë politike dhe diplomatike në Perandorinë Osmane mban vulën e një përkushtimi rreth dy çështjeve tejet të rëndësishme: të përpjekjet për ta reformuar atë, që të kthehej në një shtet modern, dhe të përpjekjeve që Shqiptarët si komb brenda për brenda saj të fitojnë statusin e autonomisë.

Kjo e dyta, gjithsesi lidhet me përpjekjet që në Stamboll në vitet 1864 e 1867, u bënë për hartimin e një alfabeti të përbashkët për gjuhën shqipe dhe për të formuar një shoqëri kulturore shqiptare. Ismail Qemali u shpreh atëherë kundër përdorimit të alfabetit arab për gjuhën shqipe dhe u bashkua me Pashko Vasën, me Kostandin Kristoforidhin dhe me intelektualë të tjerë që ishin përkrahës të alfabetit latin.<sup>1150</sup>

Nga kjo kohë, Ismail Qemali, pak a shumë, do të jetë i lidhur me veprimtarinë kombëtare, por pa u ndarë asnjëherë nga ajo e politikanit aktiv osman qoftë në pozitë apo në opozitë, brenda apo jashtë vendit. Madje, edhe kur do të gjendet në shërbim të Perandorisë Osmane, si guvernatori i saj në provincat e largëta dhe së fundi në Tripoli (1900), prej nga edhe do të arratiset për në Europë, Ismail Qemali, mbetet në këtë vijë duke bërë përpjekje që autoritetin e të parës ta shfrytëzojë për këtë të dytën. Ndërkohë që pas rrëzimit të sundimit absolut të Sulltan Hamitit dhe kthimit të tij në Parlamentin Osman si deputet me mandatin e Vlorës, pa hequr dorë nga roli i opozitarit liberal, Ismail Qemali kthehet domosdoshmërisht në lider të Lëvizjes Kombëtare, meqë këtë rol do t'ia imponojnë rrethanat e krijuara pas hapjes së konfliktit të thellë të Shqiptarëve me Xhonturqit. Këtë rol do të mundohet ta balancojë politikisht në mënyrë që kërkesat e Shqiptarëve për statusin e kombit si dhe autonominë brenda Perandorisë Osmane të ishin në përputhje me frymën e reformave perandorake që asaj i dilnin nga zotimet ndërkombëtare, veçmas nga paragrafi 23 i vendimeve të Kongresit të Berlinit për ndryshime.

Edhe pse kërkesën për autonomi do ta shohë si një zgjidhje kalimtare, në disa faza, gjithnjë duke iu referuar mundësisë së thyerjes së *status quo-s*, nuk do të përjashtojë edhe format tjera, siç ishte federata me Grekët, ose protektoratet e fuqive të mëdha. Por, edhe përkundër “variantëve” të natyrës politike dhe diplomatike, qëndrimin të autonomisë shqiptare në kuadër të Perandorisë Osmane, Ismail Qemali parimisht do t'i mbetet besnik dhe do ta mbrojë deri sa do të shpërthejë Lufta e Parë Ballkanike. Si do të shihet, nga kjo do të lirohet vetëm atëherë, kur pasi që Aleatët Ballkanikë do ta fitojnë luftën kundër Perandorisë Osmane dhe ushtritë e tyre do të pushtojnë Shqipërinë, ministri i jashtëm austro-hungarez, Berthold, gjatë

---

<sup>1150</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 293.

takimit në Bukuresht më 17 nëntor 1912, do t'ia bëjë me dije se për Shqiptarët kishte përfunduar koha e autonomive dhe fillonte koha e përpjekjeve për shtet të pavarur etnik.

Duhet thënë se ky qëndrim politik, megjithatë, ishte i mbështetur në platformën që dilte nga ideologjia kombëtare e Sami Frashërit, e shtruar në veprën *“Shqipëriaç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet?”* dhe e pranuar nga e gjithë Lëvizja Kombëtare. Madje mund të thuhet se Ismail Qemali, pa marrë parasysh gjuhën politike dhe diplomatike që përdori në përputhje me situatat e caktuara, ndoqi vijat themelore mbi të cilën Sami Frashëri vuri theksin, siç ishte krijimi i shtetit shqiptar, goftë edhe si autonom, si dhe kthimin e Shqipërisë kah qytetërimi europian.

Propagimin e platformës shqiptare në përputhje me kornizat që ia kishte përcaktuar Sami Frashëri, Ismail Qemali do të fillojë ta marrë përsipër pasi që të arratiset nga Turqia në prillin e vitit 1900, kur do të kalojë fillimisht në Athinë dhe prej andej do të shkojë në Napoli, Romë, në Lozanë, në Paris, e në Bruksel për t’u vendosur në Londër, ku do të qëndrojë për disa vite. Ky rrugëtim në të vërtetë do të hapë fazën e parë dhe më aktive të përpjekjeve diplomatike të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare që të përhapë zërin e vetë me kompetencë nëpër qendrat politike dhe diplomatike të vendosjes nëpërmes një autoriteti të lartë siç ishte Ismail Qemali, i cili për Fuqitë e Mëdha shfaqej si referencë e pakapërcyeshme, meqë ai në të njëjtën kohë ishte edhe politikan i lartë osman nga radhët e opozitës, siç ishte ajo e Xhonturqve e cila qendrën e vet e kishte në Paris. Ai autonominë shqiptare dhe emancipimin kulturor dhe arsimor të tyre, mendohej t’i paraqiste në kuadër të reformave që Perandoria Osmane që duhej t’i bënte që të forcohej në përputhje me zotimet që kishte marrë nga Fuqitë e Mëdha qysh nga koha e reformave të Tanzimatit, por që ato ngulfatëshin nga regjimi despotik i Sulltan Hamitit.

Programin politik për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare Ismail Qemali për herë të parë e shfaqti publikisht në intervistën që i dha gazetës së njohur italiane *“La Tribuna”*, më 21 maj 1900, kur ende ndodhej në Romë, duke e shpalosur atë si pjesë e reformave perandorake. Kjo do të bëjë jehonë të madhe. Gazeta italian, në komentën përcjellës, projektit do t’i japë notë pozitive ndërsa Ismail Qemalin do ta quajë *“dashamirë të singertë të Perandorisë Osmane dhe zëdhënës të matur të çështjes shqiptare”*. Për të do të thotë se *“zgjdhjen e çështjes shqiptare nuk e sheh me shkëputjen nga Perandoria, por me një autonomi politike, e cila do të arrihej në bashkëveprim me të”*, me ç’rast thuhet *“se ajo e forcon atë”*. Ndërsa më 15 tetor të po atij viti ai botoi në revistën *“Albania”* thirrjen *“Vëllezërve Shqiptarë”*, kuvihe-shin në spikamë qëndrimet kryesore të programit kombëtar.

Në të dyja këto dokumente Ismail Qemali parashtroi si një kërkesë të ngutshme, të drejtë e të rëndësishme - njohjen e kombësisë shqiptare “*si një kurm e një komp që rrojnë tubërisht në Shkodër, në Kosovë, në Manastir e në Janinë, e te j këntej në viset e tjera të Turqisë europiane*”.<sup>1151</sup>

Më tutje Ismail Qemali sqaron, gjithnjë duke folur në emër të Shqiptarëve se “*ne duam vetëm bashkimin dhe unitetin e racës sonë shqiptare, përparimin e saj intelektual dhe ekonomik me qëllim që të bëhemi mjaft të fortë për të kundërshtuar atë që synon të përpijë*”, për të rrumbullakuar këtë artikulum me përkatësinë e tyre europiane, që siç shprehej ai “*në gjak kanë mbetur gjithmonë europiane*”.<sup>1152</sup>

Krahas përkatësisë europiane të Shqiptarëve dhe përkatësisë së qytetërimit të saj, që përbënte edhe thelbin e platformës kombëtare të Shqiptarëve të shprehur nga Sami Frashëri në veprën “*Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet?*”, Ismail Qemali do t’i kushtojë vëmendje të duhur edhe aspektit të autonomisë shqiptare në përbërje të Perandorisë Osmane si dhe kërkesave emancipuese të Shqiptarëve, në mënyrë, që siç thotë ai, të jenë në gjendje “*që të vetëurdhërohen (vetëqeverisen) sa më mirë*”.

Duke u thirrur në artikullin 23 të Traktatit të Berlinit, Ismail Qemali kërkonte që edhe Shqipërisë t’i jepej statusi që i ishte dhënë Kretës në vitin 1897 në saje të ndërhyrjes së fuqive të mëdha europiane. Duke pasur kujdes që të mos bie në kundërshtim me frymën e *status quo-s*, meqë ashtu përjashtohej nga procesi politik, thoshte se nuk përkrahte shkëputjen e Shqipërisë nga Perandoria Osmane, por kërkonte një organizim të tillë, ku do të respektohej edhe e drejta e Shqiptarëve për autonomi.<sup>1153</sup>

Gazetës italiane, po ashtu, do t’ia shprehë dëshirën e Shqiptarëve të kishin marrëdhënie sa më të mira me Grekët, Italianët dhe fqinjët, sepse ato ishin edhe në interesin e të gjithëve. Madje, me këtë rast ai do të zërë në gojë edhe një marrëveshje greko-shqiptare, duke e arsyetuar me atë se “*mirëkuptimi midis Grekëve dhe Shqiptarëve duhet të ketë si bazë zhvillimin e tyre paralel brenda sferave të tyre kombëtare*”.<sup>1154</sup>

Ai me këtë rast do të shprehet në favor të *status quo-s*, por nuk e kuptonte këtë gjë pa reforma, të cilat çështjes mund t’ia pakësonin potencialin e krizës.

---

<sup>1151</sup> Po aty, faqe 296.

<sup>1152</sup> Po aty, faqe 296.

<sup>1153</sup> Po aty, faqe 296.

<sup>1154</sup> Shih intervistën e gjatë të Ismail Qemalit me Lalit Paternostro te “*La Tribuna*”, 27 korrik 1907, cituar sipas S.Skëndo: “*Zgjimi kombëtar shqiptar*”, Tiranë, 200-, faqe 173.



Këto qëndrime Ismail Qemali i shprehi edhe në gazetën “*Selamet*” (Shpëtimi) në turqisht, greqisht dhe shqip. Edhe me këtë rast ai mbrojti interesat e popullit shqiptar, të cilat i gjeti në disa pikëpamje identike me interesat e Grekëve.<sup>1155</sup>

Për shkak të këtij identifikimi interesash (me Grekët), ai u pa me shumë dyshim prej mjaft patriotësh Shqiptarë të asaj kohe. Disa prej të cilëve shkuan aq larg sa ta quanin një vegël të politikës greke. Njëri ndër ta ishte Faik Konica. Ai kundërshtoi fuqimisht politikën e tij pro-greke, të cilën e pa të dëmshme për çështjen shqiptare.<sup>1156</sup>

Mosbesimet e tilla që do ta përcjellin Ismail Qemalin, më pak ishin çështje e luhatjeve ndaj qëndrimeve politike, që dilnin nga platforma kombëtare e mbështetur mbi veprën e Sami Frashërit dhe të ideologjisë së tij, e më shumë të natyrës së sjelljeve diplomatike në rrethanat e caktuara, të cilat nënkuptonin nuancime të ndryshme në përputhje me maksimën se politika paraqet artin e të mundshmes edhe atëherë kur nga ajo kërkohej e pamundshmja. Kjo madje edhe ishte e domosdoshme për një personalitet të rëndësishëm si Ismail Qemali, i cili, pos tjerash, kishte edhe për detyrë, që përballë situatave tepër të ndërlikuara nëpër të cilat kalohej, të testonte mundësitë që edhe Shqiptarët të fushonin në lojë letrat e tyre qoftë edhe me rrezikun që në disa raste t’u digjeshin, siç do t’i ndodhë me atë greke dhe më vonë edhe me atë italiane në mënyrë që në fund të mbeten vetëm me atë austro-hungareze, e cila ishte vendimtare, që Shqipëria të Shpallte pavarësinë Kombëtare.

Por, si do të reagojnë Fuqitë e Mëdha ndaj një programi politik të Shqiptarëve, i cili ndërlidhte ideologjinë e Sami Frashërit dhe diplomacinë e Ismail Qemalit drejt jetësimit të parametrave të tij kryesorë: njohjes së Shqiptarëve si komb dhe pranimit të autonomisë politike, e cila duhej të arrihej me mjete politike dhe diplomatike kur duhej të përballonte kundërshtimet e brendshme që i vinin nga Perandoria Osmane, të cilat në dukje shfaqeshin thujtë të papërballueshme?

Karshi kësaj dileme të madhe, roli i dyfishtë i Ismail Qemalit: si politikan osman dhe si Rilindas shqiptar njëherësh, me të drejtë zgjonte dyshimin rreth një dihomie politike që mund të ndërlidhte për arsye taktike dhe strategjike nga jashtë qëndrimin refuzues të Sulltan Hamitit ndaj çështjes së autonomisë shqiptare me përcaktimin e Shqiptarëve që ta ruajnë Perandorinë në përputhje me këtë kushtëzim.

---

<sup>1155</sup> Shih “*Kujtime*” të Ismail Qemal Vlorës, të botuar në Tiranë, 1997, faqe 229-249.

<sup>1156</sup> Albania, VII (1902).

Ky aspekt, sado spekulativ, do të ndikojë thellimin e mëtutjeshëm të krizës ballkanike, meqë fqinjët e Shqiptarëve (Serbët, Grekët dhe Bullgarët) tashmë ndodheshin në një fazë kur u ishin nënshtruar planeve gjithnjë e më të hapura, që ta gllabëronin Shqipërinë. Ndërkohë që disa nga fuqitë e mëdha europiane, në radhë të parë Austro-Hungaria, në emër të pengimit të këtij zhvillimi, po ashtu do të thurin plane të ndryshme si duhej vepruar me këtë rast, ku si do të shihet, nën rrogos do të përpunohen variante të ndryshme rreth ardhmërisë së Shqipërisë dhe statusit të saj nga autonomia e mbikëqyrur nga Fuqitë e Mëdha e deri te aneksimi i saj?

Këtu mund të shtrohen edhe shumë pyetja të tjera, por që asnjëra prej tyre nuk do të mund t'i ikë vlerësimit se programi politik Shqiptarët mund t'i mbante për-kohësisht në përbërje të Perandorisë Osmane, mund t'i kthente në një poligon luftime, siç do të ndodhë pak më vonë me rastin e shpërthimit të Lutës së Parë Ballkanike, por nuk mund t'ua ndalte rrugën që të gjenin vendin në skenën politike dhe shtetërore europiane, pa marrë parasysh se nëpër çfarë vështirësish do të kalonin, sepse ishin rrethanat historike dhe sferat e interesit, që kësaj çështje doemos ia detyronin një përgjigje qoftë që të jetë edhe e padrejtë.

## KAPITULLI I GJASHTË

### FUQITË MËDHA DHE PARALOJA E LUFTËRAVE BALLKANIKE

### KRIZËS SË MAQEDONISË SKENAR HEGJEMONIST RUSO-SLLAV

Fillimisht mund të thuhet se Fuqitë e Mëdha, pa përjashtuar as Rusinë, e dinin se ekzistonte një çështje shqiptare, e cila po bëhej gjithnjë e më e pranishme, pa marrë parasysh sa dhe si e trajtonin atë. Fuqitë e Mëdha, përfshirë edhe Rusinë, po ashtu, e dinin se asaj, tashmë i duhej një përgjigje, pa marrë parasysh se çfarë do të jetë ajo, sado që nxjerrja e saj nga një rreth thuaje vicioz, ku ngatërroheshin interesat strategjike, ato të vendeve fqinje si dhe të Shqiptarëve, kërkonte një “formulë magjike”. Madje, edhe kur do të ndodhë që ajo të anashkalohej me “formulime parimore” të aprovuara në Kongresin e Berlinit 1878, me të cilat Perandoria Osmane ngarkohej që të kryente reforma të brendshme në dobi të popujve europianë që mbante (veçmas të krishterëve), Fuqitë e Mëdha gjithnjë e më shumë do të

binden se faktori shqiptar kthehej në një katalizator të fuqishëm, i cili ushqente krizën ndërkombëtare njësoj kur përfillej dhe kur nuk përfillej. Të vetëdijshëm për këtë fakt të pashmangshëm, do të përpiqen që ta mbajnë sa më gjatë nën tretmanin e “paprekshmërisë”, që lejonte terapia e *status quo-s*, e cila dihej se nuk mund vazhdonte shumë, por ajo u lejonte hapësirë planeve, të cilat atë mund ta kthenin në “*shkas*” për qëllime të caktuara siç ishin nga ato për aneksim e deri tek copëtimi, të cilave u rrinin në mes edhe projektet e kompromiseve të ndryshme (e një shteti autonom dhe skenarë të ngjashëm), që megjithatë nxirrnin në pah interesin që ekzistonte për të, interes ky që bënte të ditur se ajo nuk mund të hiqej përfundimisht nga rendi i ditës me shuarjen e saj - siç pretendonin fqinjët e saj (serbët, grekët, malaziasit) e as me dhënien e një përgjigjeje gjysmake, por sa më vonë që të jetë e mundur - siç do të dëshironin disa nga Fuqitë e Mëdha.

Duhet thënë se do të jetë pikërisht diskursi i ushqimit të krizës ballkanike dhe europiane njësoj kur ajo përfillej dhe kur nuk përfillej, që çështjen shqiptare e bënte edhe më komplekse dhe njëherësh edhe më të rrezikshme. Sepse, tashmë ishin vetë Shqiptarët që me kërkesat e tyre për autonomi politike gjërat po i vënin në lëvizje nga brenda, që ndonëse kjo nuk rrëronte *status quo-n* e vënë nga jashtë, megjithatë drejtpërdrejtë ndikonte faktorët e jashtëm, në radhë të parë shtetet fqinje (Serbinë, Malin e Zi, Greqinë dhe Bullgarinë), të viheshin në veprim për ta penguar këtë zhvillim, qoftë edhe me kërcënimin e futjes në luftë me Perandorinë Osmane, siç do të ndodhë në të vërtetë në vjeshtën e vitit 1912. Kështu, në njërin anë kërkesat e Shqiptarëve për autonomi brenda Perandorisë Osmane, të cilat bëheshin gjithnjë e më dominuese sa më shumë që forcohej lëvizja opozitare kundër Sulltan Hamitit, ku Shqiptarët luanin një rol të rëndësishëm në të dhe si do të shihet do të jenë përcaktues në përmbysjen e despotizmit të tij në verën e vitit 1908, dhe në tjetrën anë përgatitjet e fqinjëve të Shqiptarëve ta pengonin këtë, qoftë edhe me mjetet e luftës, do t’ua hapin rrugën rivaliteteve të Fuqive të Mëdha në këtë zhvillim, të dukshme ose të padukshme. Këto rivalitete megjithatë do të jenë të natyrale të ndryshme. Midis përkrahësve të Shqiptarëve (Austro-Hungarisë dhe Italisë) - do të jenë të natyrës politike, kulturore dhe ekonomike. Ndërsa, midis kundërshtarëve të Shqiptarëve, (Serbëve, Malaziasve, Grekëve dhe Bullgarëve), të shumtën - do të jenë të natyrës pushtuese.

Kur thuhet kështu kihet parasysh dallimi midis rivalitetit afatgjatë austriak dhe më vonë të atij italian, që mbështetej në përkujdesjen misionare ndaj popullatës shqiptare të besimit katolik, që shtrihej edhe në planin e gjerë kulturor dhe emancipues të Shqiptarëve dhe, në shumë aspekte ishte në përputhje edhe me programin

e Rilindjes Kombëtare, dhe atij që Shqiptarëve u vinte fillimisht nga Greqia dhe më vonë edhe nga Serbia dhe Mali i Zi, i cili ishte i një natyre thjeshtë hegjemoniste. Madje, siç u zu në gojë më parë, rivaliteti austro-italian ndaj Shqiptarëve dhe në Shqipëri, nga shumë aspekte do t'i ndihmojë zgjimit kombëtar shqiptar dhe do të ndikojë në mënyrë mobilizuese përcaktimet e tij emancipuese dhe politike në përgjithësi. Ndërkohë që fqinjët e Shqiptarëve, Serbët dhe Grekët, lëvizjet e tyre nacionale do t'i fillojnë me shpalljen e programeve kombëtare mbi baza hegjemoniste (Serbët “*Naçertanjen*” dhe Grekët “*Megali idenë*”), me anën e të cilave parashihej zhdukja e çështjes shqiptare.

Shfaqja e programeve serbe dhe greke, do ta ketë edhe “të mirën” e vet, ngaqë Shqiptarët, për t'i ikur gllabërimit të fqinjëve, të mendojnë për fatin e tyre dhe ardhmërinë në rrethanat kur për ta e sigurt ishte vetëm pasiguria, gjë që edhe kjo do të jetë një shtysë për zgjimin e tyre kombëtar para se të bëhej vonë.

Kundruall këtyre sfidave, edhe kur dukej se interesimi i fqinjëve për ta kishte të bënte me përkrahjen që të përfshiheshin në lëvizjen antiosmane, do të shihet se e gjitha lidhej me qëllimet që të shfrytëzoheshin të futeshin në luftë me Perandorinë Osmane për ta dobësuar atë, që pastaj Serbët dhe Grekët, të përfitonin prej ndeshjes së Shqiptarëve me Osmanët dhe dobësimit të dyanshëm në mënyrë që kështu më lehtë t'i kthenin në pre të tyre.

Të udhëhequr nga kjo strategji, Serbia dhe Mali i Zi, do të fusin diçka nga armët në pjesët veriore të Vilajetit të Shkodrës dhe në veri të Kosovës. Me këtë rast do të lidhin marrëveshje të veçanta me disa nga feudalët dhe bajraktarët e këtyre viseve, siç ishin ato me Isa Boletinin e ndonjë tjetër, që të mbroheshin pronat e Serbëve dhe ato të manastireve, por ata do të bëjnë çmos që kryengritjet e tyre kundër Osmanëve të mbikëqyreshin prej tyre.<sup>1157</sup>

Natyrisht se në këtë hesap me feudalët Shqiptarë Beogradi dhe Cetina përpiqeshin t'u shiteshin miq dhe mbrojtës të tyre madje, duke u premtuar se nuk do t'u prekej besimi (feja) e as traditat e tyre, siç nuk do t'u prekeshin edhe pronat që kishin.

---

<sup>1157</sup> Më gjerësisht rreth bashkëpunimit të disa feudalëve shqiptarë nga Kosova me Serbët si dhe furnizimit të tyre me armë dhe disa marrëveshje të njëanshme me ta para dhe gjatë kryengritjeve të viteve 1908-1912, ku më së shumti bëhet fjalë për Isa Boletinin, shih Perunović, Branko: “*Pisma srpskih konzula iz Prištine 1890-1900*”, Beograd, 1985, faqe 366-368; Abdylil, Tahir: “*Hasan Prishtina*”, monografi, Prishtinë, 1990; Cana, Zekeria: “*Lëvizja kombëtare shqiptare në Kosovës 1908-1912*”, Prishtinë, 1979; Zavalani, Tajar: “*Historia e Shqipnisë*”, Tiranë, 1998; Skendi, Stavro: “*Zgjimi kombëtar shqiptar*”, Tiranë, 2000; Clayer, Nathanic: “*Në fillim të nacionalizmit shqiptar*”, Tiranë, 2009; Jacques, Edwin: “*Shqiptarët*”, 1995; Glenly, Misha: “*Historia e Ballkanit 1804-1999*”, Tiranë, 2007.

Në këtë strategji, Grekët shfaqen shumë më perfidë se Serbët, sepse lëvizjen e helenizmit do ta përdorin që shumë nga Shqiptarët t'i bëjnë për vete dhe t'i përfshijnë në të, veçmas faktorin e fuqishëm arvanitas si dhe Shqiptarët e besimit ortodoks, të cilët pas dështimit të luftës së Ali Pashë Tepelenës për mvehtësimin e Pashallëkut të Janinës nga Perandoria Osmane në vitet 1820-22, gjithë energjinë do ta kthejnë në anën e tyre për ta vu në shërbim të luftës për pavarësinë e Greqisë, e cila do të arrihet në vitin 1830. Këtë rrugë Grekët do ta ndjekin edhe nga koha e Krizës Lindore e tutje, kur do të bëjnë përpjekje që edhe më tutje Shqiptarët ortodoks dhe arvanitasit tashmë të përfshirë në përbërje të shtetit grek, t'i përfitojnë për qëllimet e tyre, duke i joshur që luftën kundër Perandorisë Osmane ta lidhnin me disa qëllime të përbashkëta politike, siç ishin ato që do të shfaqen gjatë bisedimeve të para të Abdyl Frashërit dhe Mehmet Ali Vrionit me kryeministrin grek në vitin 1878 gjatë luftës osmane-ruse kur do të përmendej një aleancë greko-shqiptare, e cila nga Shqiptarët shihej si një mundësi për një shtet federativ shqiptaro-grek. Kjo nga Grekët do të refuzohet nga frika se në një shtet të tillë prej dy njësive identitare, Shqiptarët do të shfaqeshin si shumicë, ndërkohë që Grekët do të mbeteshin pakicë, siç ishin në të vërtetë, dhe siç do të mbeteshin po mos të ishte helenizimi i arvanitasve dhe i Shqiptarëve ortodoksë, të cilin do ta vënë në veprim që nga themelimi i shtetit grek.

Në të vërtetë, helenizmi i mirëfilltë si lëvizje kulturore jashtë helenizmit si metodë politike për asimilimin e Shqiptarëve të besimit ortodoks, do të mbështetet edhe nga shumë intelektualë arvanitas, Shqiptarë të besimit ortodoksë si dhe Italo-Arbëreshë, të cilët mendonin se helenizmi mund të shfrytëzohej që edhe Shqiptarët të përfshiheshin në projektet e përbashkëta me Grekët për t'u liruara nga Perandoria Osmane.

Në fillimet e shekullit XIX do të ketë përpjekje dhe nisma të ndryshme. Si të tilla do të vazhdojnë edhe më vonë dhe madje deri në prag të luftërave ballkanike. Por, shfaqja e "*Megaliidhesë*" (programit nacional grek) i vitit 1844 do t'ua mbyllë rrugën projekteve të sinqerta të të dy popujve për veprime të përbashkëta, për t'ia lëshuar rrugën hegjemonizmit grek ndaj Shqiptarëve. Ai do të kthehet në program të qëndrueshëm politik të shtetit grek që nga themelimi e tutje për të vazhduar në të gjitha fazat, pa përjashtuar këtu edhe prapaskenat që Athina do t'ia bëjë edhe shtetit shqiptar dhe çështjes shqiptare në përgjithësi.

Në rrethanat e reja, megjithatë, kur lëvizja kombëtare shqiptare tashmë shfaqej me program të qartë politik, që për platformë kishte manifestin e Sami Frashërit nga vepra "*Shqipëriaç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhetë?*", ndërkohë që edhe

Italo-Arbëreshët dhe diaspora shqiptare në Rumuni, në Bullgari, Egjipt dhe gjetiu, me punën e tyre të madhe, tashmë kishin zënë vendin e merituar në këtë lëvizje kombëtare ndër më të fuqishmet që ishte parë ndonjëherë midis tyre, do të ndryshojë dukshëm edhe sjellja e fqinjëve të Shqiptarëve ndaj këtyre zhvillimeve. Ata do të përqendrohen në njërin anë tek trysnia që i bëhej Perandorisë Osmane që të zhvillonte reformat në pjesën europiane, kryesisht në dobi të popullatës së krishterë (Serbëve dhe Bullgarëve) - me çka drejtpërdrejt provokoheshin Shqiptarët që të reagonin në cilësinë e dyfishtë (si kundërshtarë të reformave dhe kundërshtarë të Perandorisë Osmane) - dhe në tjetrën anë tek instrumentalizimi i çështjes së Maqedonisë në dëm të çfarëdo opsioni të autonomisë shqiptare, që do të pasqyrohej me bashkimin e katër vilajeteve shqiptare në një (atij të Shkodrës, Kosovës, Manastirit dhe të Janinës). Kështu që nga lufta greko-osmane e vitit 1896/7 e deri tek Revolucioni Xhonturk i vitit 1908 e gjithë vëmendja do të përqendrohet te çështja e Maqedonisë, ku tashmë ndodhej çelësi i mbajtjes së Perandorisë Osmane nën trysni të vazhdueshme nga brenda dhe jashtë çfarëdo mundësie që të pranonte kërkesat e Shqiptarëve. Ndërkohë që me kërcënimin e një ndërhyrjeje të vendeve ballkanike në këtë krizë (Serbisë, Malit të Zi, Greqisë dhe të Bullgarisë) - që do të thoshte thyerje e *status quo-s* me anën e një lufte që këto vende do ta ndiznin me Perandorinë Osmane - Rusia, në një farë mënyre, mbante penjtë e këtij zhvillimi dhe madje shumë ngjarjeve ua përcaktonte edhe dinamikën në mos edhe epilogun.

Meqë edhe Rusia e dinte se përdorimi jashtë mase i shteteve sllavo-ortodokse të Ballkanit mund të vinte në veprim vendet e Aleancës Trepalëshe (Austro-Hungarinë, Gjermaninë dhe Italinë) për ndonjë ndërhyrje të drejtpërdrejtë në Ballkan, e cila do të mund të shfrytëzohej më së lehti nga sjellja e Shqiptarëve dhe me anën e tyre, do të përpiqet që të ndajë interesin austro-hungarez nga ai italian, duke e ngritur atë në “interes të veçantë” midis Vjenës dhe Petërburgut në përputhje me marrëveshjen e vitit 1881 kur këto njohën pozitat e njëra-tjetrës në Ballkan (përfshirë këtu edhe Gjermania) dhe u zotuan se çdo ndryshim në *status quo*-në territoriale të Perandorisë Osmane në Europë do të bëhej me anën e një marrëveshjeje të përbashkët ndërmjet tyre.<sup>1158</sup>

Por, lufta osmane-greke për Kretën (1896/7) si dhe pasojat e saj të njohura gjërat i nxori nga ky kontekst. Kjo shqetësoi njësoj Austro-Hungarinë dhe Rusinë, që kishin frikë se mos ajo zgjerohej jashtë mbikëqyrje së tyre dhe kështu fuste në lojë edhe faktorë të tjerë, të cilët do të mund t’ua ndryshonin përmbajtjen marrë-

<sup>1158</sup> Shih pikën II të traktatit të A. F. Pribram “*The Secret Treaties of Austro-Hungary 1879-1914*”, Kembrixh, Mass, 1920, I, 39, sipas Skëndi, Stavro: “*Zgjimi kombëtar shqiptar*”, Tiranë, 2000. Faqe, 265.

veshjeve në parim austro-ruse rreth mandatit për mbikëqyrjen po edhe përgjigjen që duhej t'i jepej çështjes shqiptare kur kjo shfaqej e pashmangshme (në rrethanat e shpërbërjes së Perandorisë Osmane), e cila po sipas qëndrimit të Petërburgut të vitit 1881, duhej të zgjidhej me një marrëveshje midis këtyre dy perandorive, që duhej të përkonte me formulën “pajtuese” *gjysmë-gjysmë*, ku binin kërkesat maksimaliste të Shqiptarëve për bashkim e katër vilajeteve, dhe po ashtu binin kërkesat e Serbëve, të Grekëve dhe të Bullgarëve, për gllabërimin e hapësirës shqiptare dhe të shuarjes së plotë të çështjes shqiptare në përputhje me projektet e tyre hegjemoniste.

Formula austriake-ruse “*gjysmë-gjysmë*”, do të paralajmërohet në prill të vitit 1897, në takimin e ministrit të jashtëm të Austro-Hungarisë Galuhovskit me atë rus Muraviev. Kryediplotatët e këtyre vendeve, duke marrë parasysh interesat jetësore të të dy perandorive dhe duke synuar shmangien dhe “*rrezikun e një rivaliteti shkatërrimtar për paqen në Europë*”, ranë në ujdë për rregullime të caktuara në rast se *status quo*-ja në Ballkan nuk do të mund të ruhej.<sup>1159</sup>

Në një notë të 8 majit 1897, Vjena ishte pro aneksimit të Bosnje-Hercegovinës dhe të sanxhakut të Novi Pazarit, por po ashtu deklarohet se ishte pro krijimit të një shteti të pavarur shqiptar “me përjashtimin e çdo sundimi të huaj, që të shtrihet nga Janina në Shkodër”,<sup>1160</sup> me një hapësirë të mjaftueshme në anën lindore. Në këtë letër po ashtu Vjena deklarohet se ishte pro copëtimit të territoreve osmane në gadishull ndërmjet shteteve të ndryshme ballkanike.

Në përgjigjen ruse, nuk kundërshtoheshin propozimet e Vjenës, pos që për pavarësinë e Shqipërisë me shtrirjen nga Janina deri në Shkodër, thuhej se “*meqë këto çështje i përkisnin të ardhmes, ishte e vështirë të merreshin vendime që tani*”.<sup>1161</sup>

Këtë duhej pranuar më shumë si një qëndrim diplomatik të Rusisë për ta qetësuar Italinë se sa të mospajtimin me planet austro-hungareze rreth Shqipërisë dhe Shqiptarëve, të cilat, në forma të ndryshme, do të vazhdojnë të mbesin në dosjet e këtyre dy fuqive, pa marrë parasysh si dhe sa do të pasqyrohen në njërën anë në rivalitetin e Austro-Hungarisë me Italinë dhe në tjetrën anë tek raportet e Rusisë me satelitët e saj në Ballkan: Serbinë, Malin e Zi dhe Bullgarinë, pa përjashtuar këtu edhe ndikimin që do të ketë ndaj Greqisë, ndonëse nga ana e saj do të pranohej si interes francez dhe pjesërisht britanik.

Mirëpo, në rrafshin e politikës globale europiane, pajtimi në parim midis Austro-Hungarisë dhe Rusisë rreth çështjes shqiptare si dhe problematikës së për-

---

<sup>1159</sup> Shih W.M. Corlegren: “*Iswolsky und Aehrenthal vor der bosnischen Annexionskrise*”, Wien, 1955, faqe 14.

<sup>1160</sup> Po aty, faqe 14.

<sup>1161</sup> Skëndi, Stavro: “*Zgjimi kombëtar shqiptar*”, Tiranë, 2000, faqe 266.

gjithshme rreth fatit të pjesës europiane të Perandorisë Osmane, po qe se do të prishej *status quo*-ja, do të ndezë rivalitetet rajonale midis Serbisë, Greqisë dhe të Bullgarisë, të cilat ndonëse të fokusuara te Maqedonia dhe çështja e saj, do të prekin edhe faktorët tjerë jashtë ballkanik, ku pashmangshëm viheshin në lëvizje edhe fuqitë e tjera europiane veçmas Britania e Madhe dhe Gjermania.

Këto vende, edhe pse nuk lidheshin me interesa të drejtpërdrejta në Ballkan, megjithatë nuk mund të rrinin manash kur këto rivalitete në dukje “lokale” mund të ktheheshin në shkase për çrregullime të tjera, siç ishin ato midis Serbisë dhe Bullgarisë, pastaj Greqisë dhe Bullgarisë apo edhe ato të Malit të Zi si kartë e re italiane dhe të ngjashme, të cilat për referencë do të kenë Maqedoninë dhe çështjen e saj, si një vatër e re krize, ku secili mund të përdorte letrat e veta dhe t’i fuste në lojë, siç do të ndodhë në të vërtetë, por tash me rrezikun e konfrontimeve të ndërsjella, ku gjërat mund të dilnin nga mbikëqyrja e me të të rrezikohej edhe stabiliteti i përgjithshëm.

Në këtë zhvillim kishte edhe disa momente të tjera, të cilat do të ndikojnë që në pokerin ballkanik dhe në përgjithësi në politikën lindore të Fuqive të Mëdha, të ndërlikohen edhe Britania e Madhe dhe Gjermania në një rivalitet, me interesa të ndryshme, ku Gjermanët, duke iu bashkuar Austro-Hungarisë dhe Rusisë, kërkonin stabilitetin e Perandorisë Osmane, sepse ashtu zgjerimin dhe thellonin bashkëpunimin ekonomik me Portën e Lartë. Ndërsa, në tjetrën anë, Britanisë së Madhe kjo nuk i shkonte për shtati dhe kërkonte dobësimin e saj, edhe nëqoftëse që kjo do të bëhej në dëm të thyerjes së *status quo*-s, sado që për ruajtjen e të cilës kishte dhënë pëlqimin në kuadër të korifeut european të vendosjes dhe këtë e theksonte edhe më tutje.

Para se të ndodhë shpërthimi i ri i rivalitetit britanik dhe atij gjerman ndaj Perandorisë Osmane mbi bazat e interesave të tyre ekonomike, të cilat, si do të shihet do të jenë përcaktuese në këtë zhvillim dhe madje asaj do t’ia caktojnë edhe epilogun e njohur, për ta parandaluar këtë, Austro-Hungaria e Rusia do të shfrytëzojnë mandatin e Fuqive të Mëdha që serish t’i kthehen formulës së njohur të trysnisë ndaj Perandorisë Osmane për të kërkuar që të zbatonte reformat në pjesën europiane, dhe veçmas në Maqedoni. Meqë vetëm ashtu “parandalohet” ashpërsimi i mëtutjeshëm i krizës dhe zgjerimi i saj jashtë shemës mbikëqyrëse, të vendosur nga Vjena dhe Petërburgu me pajtimin e Fuqive të Mëdha.<sup>1162</sup>

---

<sup>1162</sup> Më gjerësisht shih te Walters, E: “*Austro-Russian Relations der Goluchowski 1895-1906*”, te “*The Slavonic and East European Review*”, London, XXXII (1953), faqe 187-214; Raport, A: “*Mazedonien und di Komitadschis*”, Berliner Monatshefte, Berlin, VIII (gusht 1930), faqe 731-744; Sosnosky, T: “*Die Bal-*



Fokusimi te Maqedonia do të bëhet jo rastësisht, meqë ajo tashmë shfaqej si strumbullar i kurdisur i krizës, një si fuqi baruti në shpërthim, që prekte që të gjitha çështjet e pazgjidhura në Ballkan, që njësoj i ushqente ato me skenarë të papara-shikuar. Por, si do të shihet, Perandoria Osmane, që nga viti 1897 kur do të paralajmërohen reformat e Sulltan Hamitit në Rumeli, do të hasë në limitet e sjelljes së saj premtese, pa mbulesë nga brenda - nga shkaku se kundërshtohet nga Shqiptarët dhe opozita në rritje e sipër, ku Xhonturqit dhe Shqiptarët gjenin gjuhën e përbashkët - ndërkohë që gjendja ndërlikohej nga fqinjët e tyre, të cilët lëshimet që ua bënte Perandoria, siç ishin ato që do të fillojnë ndaj *Ekzarkatit* bullgar nga viti 1870 e tutje, pastaj të emërimit të peshkopëve serbë në Shkup dhe Pejë në vitin 1898, hapjes së shkollave serbe në Prizren, Shkup dhe në disa pjesë të tjera të vilajetit të Kosovës dhe të atij të Manastirit, e mbi të gjitha lejimit të hapjes së konsullatave serbe në Prishtinë dhe Shkup, mundoheshin që t'i shfrytëzonin drejt sforcimit të propagandës së tyre që Kosova dhe Maqedonia për Serbët të shfaqeshin “*djep shpirtëror serb*”, ndërsa për bullgarët “*qendër e Bullgarisë së Samuilit*” dhe të ngjashme, me çka ushtrohej trysni e vazhdueshme ndaj Fuqive të Mëdha, në mënyrë që të konfigurimet e ardhshme politike të bëheshin në përputhje me këto “realitete”, të cilat ishin pjesë e konstrukteve të dhunshme, që mundësoheshin pikërisht nga ajo që shfaqej “frymë” e reformave.

I ndodhur përballë këtyre rrethanave, pra të një dobësimi të ndjeshëm nga brenda, dhe të ndërhyrjeve gjithnjë e më agresive të Serbisë, Greqisë dhe të Bullgarisë në pjesën europiane të Perandorisë, Sulltan Hamiti - duke dëshiruar që për vete të ruajë mbështetjen e Austro-Hungarisë, të Ruisë e mbi të gjitha të Gjermanisë, me të cilën ishin vendosur lidhje shumë të mira në të gjitha fushat, që sa vinin e zgjeroheshin dhe mbi to ai mbështeste që të gjitha planet për modernizimi i ekonomisë së vendit, por edhe të forcimit të pozitës ndërkombëtare duke u munduar që të kthehet në një faktor lidhës midis Lindjes dhe Perëndimit - krahas lëshimeve që do t'ua bëjë të krishterëve në emër të zbatimit të reformave, do të jetë i detyruar t'i kthehet politikës represive ndaj Shqiptarëve pikërisht atyre të cilët i kishte shpallur “lule e islamit” dhe “kala” në pjesën europiane, që kundërshtonin reformat. Ndërkohë që “pakos ushtarake” për shuarjen e revoltës kundër Shqiptarëve do t'i jepet drita e gjelbër edhe ndaj revoltës së popullsisë sllavo-maqedonase në Maqedoni, e cila pas *Ekzarkatit* e tutje, rivalitetit të njohur midis Shqiptarëve, Serbëve dhe Grekëve në këtë pjesë ia kishte shtuar edhe dimensionin

---

*kanpolitik Österreich-Ungarns seit 1866*”, band II Stuttgart und Berlin 1914; Chlymecky, L. F: „*Österreich-Ungarn und Italien. Der Westbalkan*”, Leipzig und Wien, 1907.

bullgaromadh. Kjo krizën e thellonte dhe e bënte edhe më të paparashikueshme, meqë tashmë ajo projektohet mbi çështjen e popullatës sllavo-maqedonase, të pranishme në vilajetin e Selanikut dhe pjesërisht në atë të Manastirit, ku nga Bullgaria shihej pjesë e popullit bullgar,<sup>1163</sup> ndërsa Serbia e shihte si mbetje mesjetare sllave, të afërt me serbët, ndonëse pa vetëdije të qartë nacionale.<sup>1164</sup>

Në të vërtetë Bullgaria filloi të ndërhyjë në Vilajetin e Manastirit dhe atë të Selanikut me pretendimet që një pjesë të mirë të tyre t'ia bashkëngjisë projektit të Bullgarisë së madhe, që tashmë Sofja e kishte shpallur jo pa pëlqimin e Vjenës, po edhe të Rusisë, dhe kishte filluar që me këtë synim t'i organizonte çetat bullgare (komitet), të cilat vepronin në shumë pjesë, dhe krahas atyre serbe dhe greke, destabilizonin rajonin.

Nga fundi i vitit 1890 agjitacioni bullgar në Maqedoni hyri në një fazë të re me sulme të shpeshtat të anëtarëve të “*Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase*”(VMRO). Kjo organizatë tashmë kishte një platformë të përbashkët nga një kongres i Maqedonasve dhe bullgarëve i organizuar një vit më parë në Gjenevë prej nga doli kërkesa për formimin e një Maqedonie autonome, ku do të përfshiheshin Vilajeti i Manastirit dhe ai i Kosovës.<sup>1165</sup>

Meqë popullata sllavo-maqedonase në Vilajetin e Manastirit dhe atë të Selanikut, kishte filluar të organizohej në komitete “të brendshme” me prijës vendor si Goce Delçev, Jane Sandanski dhe të tjerë dhe, vërehet se ato kërkonin bashkëpunim edhe me Osmanët dhe me Shqiptarët për t'i bërë ballë pretendimeve serbe dhe greke si dhe atyre të Patrikanës greke, Bullgaria kishte ndërhyrë me formimin e komiteteve “të jashtme” – me orientim kryekreje bullgaromadh, që vinin nga “përtej kufiri” dhe drejtoheshin nga Jankovi. Të rekrutuarit nga shteti bullgar, ku kishte ushtarakë dhe pjesëtarë të shërbimeve policore të shtetit, merreshin me veprime diversive dhe me atentate, që për qëllim kishin destabilizimin e gjendjes në vilajetet e Maqedonisë. Logjistika ruse u ndihmonte më së shumti në këto punë.

Në përputhje me këtë synim, Bullgaria tashmë kishte filluar bisedime të fshehta me Beogradin dhe Athinën rreth plaçkës që duhej ta ndanin. Kështu, vepërimitaria e çetave “kryengritëse” nga të tri shtetet, të cilat drejtoheshin prej shërbimeve të tyre ushtarake dhe informative, do të shfrytëzohet që t'u jepeshin alibi

---

<sup>1163</sup> Shih: “История в България”, Софија, 1981; Василиев, В. А; Божин Војнов: „Българската Просвета в Македонија и одридска Тракија 1878-1913“, 1982;

<sup>1164</sup> Shih: Cvijić, Jovan: „O etnografiji Makedonskih Slovena“, Beograd, 1906, faqe 12.

<sup>1165</sup> Prifti, K: “Le Mouvement national albanais de 1869 a 1900: La Ligue de Pejë”, Tiranë, 1989, faqe 149-50.

projekteve të cilat tashmë ishin hartuar për ndarjen e Maqedonisë midis tyre, gjë që krizën ballkanike e thellonte dhe e përhapte tutje saj, me çka dilte në pah një e vërtetë se kriza e Maqedonisë dhe ngritja e saj në çështje politike, nuk lidhej vetëm me zgjidhjen e çështjes maqedonase, pra të ndarjes së Maqedonisë midis këtyre shteteve, por edhe me çështje të tjera që trazonin interesat e fuqive evropiane.<sup>1166</sup>

Fuqitë e Mëdha europiane do të frikësohen nga ky zhvillim. Sidomos Austro-Hungaria, e cila ndonëse kishte një marrëveshje “parimore” me Rusinë që të mbikëqyreshin interesat e tyre në këtë pjesë dhe asgjë të mos lejohej pa miratimin e tyre, kërkoi nga Perandoria Osmane masa energjike për parandalimin e zhvillimeve të paparashikuara.

Rusia, ndonëse ishte e interesuar që Sulltan Hamitit të mos ia dobësonte pozitat karshi opozitës xhonturke e as karshi europianëve, të cilët tashmë e mbanin të lidhur për laku - meqë atë e konsideronte garant të interesave të veta në Lindje - po ashtu ndërhyri te Porta e Lartë, por duke kërkuar sjellje më të ashpër ndaj Shqiptarëve, që sipas saj shfaqeshin turbulluesit kryesor në vilajetin e Kosovës, atë të Manastirit dhe të Selanikut. Me këtë rast Rusët theksonin se veprimtaria “antislave” e Shqiptarëve shihej e lidhur edhe me autoritet Osmane, të cilët nuk ishin të interesuara për jetësimin e reformave në pjesën europiane dhe bënin lojë të dyfish-të me ta.<sup>1167</sup>

Nga ana tjetër, sa më shumë që Porta e Lartë do t'i shtojë fushatat ushtarake në Kosovë, Serbia, Bullgaria dhe Greqia, jo vetëm që nuk do të ndalin përkrahjen çetave “kryengritëse” dhe bandave të tyre në vilajetin e Manastirit dhe atë të Selanikut, por nga vera e vitit 1902, do t'i zgjerojnë edhe në Kosovë (në Veri) dhe kjo do të bëhej sipas një marrëveshjeje të fshehtë që tashmë ekzistonte midis Beogradit dhe Sofjes rreth ndarjes së zonave në “ato serbe” dhe “bullgare” në përputhje me veprimtarinë e komitëve të tyre “*në mbrojtje të popullatës së krishterë nga zullumi arnaut*”, që nuk do të thoshte tjetër pos përgatitje për ndarjen e vilajetit të Kosovës dhe atij të Manastirit midis Serbëve dhe Bullgarëve.<sup>1168</sup>

Këtij skenari do t'i hedh vaj në zjarr edhe hapja e konsullatës ruse në Mitrovicë, e cila nga Shqiptarët përjetohej si një përgatitje për aneksimet e reja sllavo-ortodokse ndaj trojeve të tyre, që këtë herë bëhej edhe me miratimin e Portës së Lartë, e cila tashmë, në emër të mbikëqyrje së zbatimit të reformave, kishte lejuar

---

<sup>1166</sup> Rappaport, A: “Mazedonien und di Komitadschis”, Berliner Monatshefte, Berlin, VIII (gusht 1930), faqe 731-744.

<sup>1167</sup> Sosnosky, T: “Die Balkanpolitik Österreich-Ungarns seit 1866”, band II Stuttgart und Berlin 1914.

<sup>1168</sup> Po aty.

përfaqësitë e huaja në Kosovë dhe Maqedoni bashkë me hapjen edhe të shërbi-meve konsullore serbe, ruse dhe greke që të vepronin në këtë drejtim. Kundër këtij vendimi, në veri të Kosovës Shqiptarët do të hidhen në një kryengritje, të cilës do t'i prijë Isa Boletini, i cili kishte marrëdhënie shumë të mira me Sulltan Hamitin.

Kryeneçësia e Isa Boletinit gjatë muajit shtator dhe tetor do të përqendrohet në pjesën përreth Mitrovicës dhe tek pronat e tij. Ajo ishte e kufizuar dhe pa pretendime të ndonjë ashpërsimi më të madh me Sulltanin. Kjo hapë dyshimin se ajo madje edhe ishte planifikuar nga Porta, si shumë veprime të ngjashme deri më atëherë, që t'u bishtnohej zotimeve që merreshin para Fuqive të Mëdha, me arsyetimin se ato nuk pranoheshin nga brenda, pra nga populli shqiptar, qëndrimi i të cilit duhej të kihej parasysh kur bisedohej për çështje që kishin të bënin edhe me ta dhe fatin e tyre.

Se mund të ishte kështu, këtë e dëshmon edhe roli i Shemsi Pashës, që si përgjegjës për të shuar revoltën e Shqiptarëve kundër vendimit të hapjes së konsullatës ruse në Mitrovicë, pas një kohe, fushatën ushtarake e zëvendësoi me bisedime të drejtpërdrejta me Isa Boletinin, me ç'rast, e bindi që të largohej në fillim nga Mitrovica dhe në fundin e nëntorit të vitit 1902, me urdhrin e Sulltan Hamitit, u soll në Stamboll dhe u emërua në rangun e rojës së pallatit mbretëror (*tüfenciler*), ku mbeti deri në vitin 1906 dhe pastaj u kthye në Kosovë me një tokë dhuratë perandorake dhe me një gradë oficeri në policinë vendore.<sup>1169</sup>

Tërheqja e Shqiptarëve të Kosovës nga një kryengritje e përmasave të mëdha, gjithsesi do t'i japë mundësi Portës së Lartë, që t'i kthehet edhe shuarjes së veprimtarisë së bandave të ndryshme në Maqedoni, të cilat kishin filluar të krijonin një gjendje tepër të nderë dhe jashtë çdo rendi, e cila rrezikonte gjithë rajonin. Kështu, gjatë muajit shtator-tetor të atij viti, ushtria osmane shtypi me ashpërsi të madhe lëvizjen e bandave në Vilajetin e Kosovës dhe atë të Manstirit, që tashmë nga Beoradi, Athina, Sofja, Moska e të tjerë, kishte filluar të emërtohej si Maqedoni, ndonëse ky emërtim nga mesjeta e këndej nuk ekzistonte. Fushata osmane ndaj bandave të armatosura u përcoll me njëfarë miratimi nga Shqiptarët në këto pjesë, të cilët kishin filluar të vuanin nga veprimtaria e bandave sllavo-maqedonase dhe greke, të cilat në shumë pjesë kishin vënë pushtet dhe ushtronin krime ndaj popullatës së pambrojtur shqiptare.

Që të parandalohet ringjallja e bandave, si kundërshpërblim për lejimin e përdorimit të fuqisë ushtarake në këto dy vilajete, Fuqitë e Mëdha do t'i kërkojnë

---

<sup>1169</sup> Gawrych, George: "Gjysmëhëna dhe shqiponja", Tiranë, 207, faqe 203.

Perandorisë Osmane, që të pranonte reformat e tjera në vilajetet e Turqisë europiane, të cilat u përfshinë në “*Udhëzime për vilajetet e Rumelisë*”, të cilat u shpallën në fillim të dhjetorit 1902 nga Porta e Lartë.

Sulltan Hamiti bashkoi tre vilajetet: atë të Selanikut, të Manastirit dhe të Kosovës në një “megavilajet”, të quajtur “*Tri vilajetet*” (*Vilayer-i Selase*) me prete ndime se ky dhe jo vilajetet shqiptare duhej të paraqesin faktorin mbështetës të saj në pjesën europiane. Ai mbështetej në shtatë pika:

- Xhandarmëria të përbëhej prej myslimanëve dhe të krishterëve sipas numrit të popullsisë dhe nevojave lokale;

- Valinjtë të kujdesen për përparimin e bujqësisë, tregtisë dhe të ndërtimit të rrugëve;

- Të formohen gjyqe civile të përbëra prej myslimanëve dhe të krishterëve;

- Të emërohet komisioni prej katër anëtarëve i cili do ta kontrollonte punën e valisë dhe të inspektorëve kryesorë në frymën e reformave;

- Pranë çdo valiu duhet të emërohet nga një kajmekam për punët administrative;

- Të themelohet titulli i inspektorit kryesor për të gjitha provincat e Turqisë europiane;

- Sistemi tatimor të mbetet si më parë.<sup>1170</sup>

Shikuar nga kjo pikëpamje, çështja e vilajetit të Rumelisë, do të duhej t’i jepte një grusht të fortë aspiratave shqiptare për një Shqipëri autonome, mbi bazën e bashkimit të katër vilajeteve (të Shkodrës, të Kosovës, të Manastirit dhe të Janinës).

Por, “Marifeti Rumeli” i Sulltan Hamitit, si shumë lëvizje të tjera të ngjashme që ai bënte që nga Tanzimati e këndeje, Shqiptarëve nuk ua hoq nga programet e tyre politike kërkesën për autonominë shqiptare, sepse ajo, nuk ishte jashtë konteksteve ndërkombëtare dhe jashtë planeve të Fuqive të Mëdha.

Kur thuhet kështu, kihet parasysh se ajo, sapo të formulohet si kërkesë e “Lidhjes Shqiptare të Prizrenit” në vitin 1878 dhe si e tillë, qoftë edhe tërthorazi, (me anën e një memorandumit nga Shkodra i ishte dërguar përfaqësuesit britanik Kongresin e Berlinit), qe përkrahur edhe nga Britania e Madhe dhe përfaqësuesi i saj në Konferencën e Ambasadorëve të Kongresit të Berlinit në Stamboll, në vitin 1880. Ndonëse aso kohe nuk kishte gjetur mbështetje nga përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha, nga ana e përfaqësuesit britanik kërkesa për vilajetin autonom shqiptar në

---

<sup>1170</sup> Pllana, Emin: “*Kosova dhe reformat në Turqi*”, Prishtinë, 1978, faqe 170.

përbërje të Perandorisë Osmane i ishte shtruar edhe Portës së Lartë, e cila që refuzua, me arsyetimin se ajo rrëronte unitetin shtetëror të Perandorisë Osmane.<sup>1171</sup>

Megjithatë, si e tillë dhe me përmbajtje të ndryshme, ajo do të referohet vazhdimisht si një mundësi e hapur pas largimit të Perandorisë Osmane nga pjesa europiane.

Sulltan Hamiti me “*Udhëzimin për vilajetet e Rumelisë*”, me arsyetimin se “*ruhej vendi nga rrënimi i brendshëm*”, sërish do t’u referohet Shqiptarëve, duke ua hedhur poshtë kërkesat, të cilat ata tashmë i kishin kthyer në platformë politike dhe i kishin shpallur haptas si një mundësi që çështja e tyre të zgjidhej në bashkëveprim me Perandorinë Osmane dhe Fuqitë e Mëdha. Njëherësh do të bëjë përpjekje që njëjtë ta pengojë edhe copëtimin e asaj që tashme nga Serbia, Bullgaria dhe Greqia theksohej si Maqedoni.

“Marifeti” Rumeli, edhe i tillë si do të parashtrohet nga Sulltan Hamiti nuk lentë për të shpresuar se çështjet do t’i vente në binarë të qetësisë e lëre më të zgjidhjes. Sepse, projekte dhe propozime për përmirësimin e gjendjes në provincat e Rumelisë, për zhvillimin e tregtisë, të bujqësisë, të zejtarisë e të punëve botërore, siç ishin ata që shfaqeshin në këtë Udhëzim, kishte pasur edhe më herët, që kishin mbetur në letër. Madje, ato, çështjet i kishin acaruar edhe më tepër, ngaqë nuk kishin përkrahjen e shtresave shoqërore (feudalët dhe aparati administrativ vendor shumë i ndryshkur), në të cilat mbështetej Sulltan Hamiti, e as te klerit fanatik islamist, i cili po ashtu kishte ndikim në këto pjesë meqë edhe më tutje ruante rolin e mbrojtësit të vatanit me anën e besimit. Kundruall këtyre rrethanave, riorganizimi i xhandarmërisë, i policisë dhe i gjykatave (duke futur në to edhe të krishterë), pastaj përdorimi i një pjese të të ardhurave lokale për nevojat e vilajeteve etj, bashkë me emërimin e një inspektori të përgjithshëm, që do të kishte kompetencat e një ministri dhe pranë tij një nëpunës civil e një tjetër ushtarak, filluan të përjetohen më tepër si përpjekje për forcimin e aparatit shtypës në shërbim të vendosjes së privilegjeve ndaj të krishterëve, se sa të ndryshimit të gjendjes, gjë që kështu edhe do të dalë. Sepse, sapo inspektori i përgjithshëm (Hysen Hilmi Pasha) me seli në Shkup, të marrë përsipër postin, vendosi një mbikëqyrje të rreptë në qeverinë vendore. Valinjte dhe mytesarifët raportonin të gjitha ngjarjet që ndodhnin në zonat e tyre të përgjegjësisë dhe, nga ana e tij, Hysen Hilmi Pasha i dërgonte rregullisht informacione pallatit të Sulltanit dhe Portës së Lartë.<sup>1172</sup>

---

<sup>1171</sup> Shih Buxhovi, Jusuf: “*Kongresi i Berlinit 1878*”, Prishtinë, 2008.

<sup>1172</sup> Gawrych, George: “*Gjysmëhëna dhe shqiponja*”, Tiranë, 2007, faqe 203.

Meqë reformat ishin gjysmake dhe përcilleshin me refuzimin e madh të popullatës, kryesisht të Shqiptarëve, që merrnin përmasat e kryengritjeve të cilat çregullonin nga brenda Perandorinë Osmane, po ku nuk mungonte edhe refuzimi i popullatës sllavo-maqedonase, e cila pos në vilajetin e Selanikut, në të tjerat, në raport me shqiptarët, ishte pakicë, që tashmë ishte përfshirë në manipulimet që i vinin nga jashtë (nga Serbia, Greqia dhe sidomos nga Bullgaria e cila ishte shumë e pranishme me komitet dhe shërbimet e tjera), Fuqitë e Mëdha mbetën të pakënaqura, veçmas nga shkakut se zbatimi i pamjaftueshëm i tyre kishte ashpërsuar edhe më tepër gjendjen ndëretnike në përputhje me ndërhyrjen nga vendet fqinje dhe interesat e tyre tashmë të njohura. Ajo kërcënonte me një shpërthim tjetër të madh midis tyre, gjë që kishte frikë se kjo do t'u shërbente si shkas vendeve ballkanike (Serbisë, Greqisë dhe Bullgarisë) që të hynin në një luftë e cila thyente *status quo*-n.

Austro-Hungaria dhe Rusia, të cilat që nga marrëveshja e Petërburgut e prillit të vitit 1897 midis Goluhovskit dhe Muravievit, kishin mandatin e Fuqive të Mëdha për Ballkanin, pasi që edhe një herë morën pëlqimin e Anglisë, të Francës dhe të Gjermanisë, më 21 shkurt 1903 i paraqitën Portës së Lartë projektin austro-rus të reformave, të cilin, pas disa kundërshtimesh u detyrua ta pranonte edhe Sulltani.<sup>1173</sup>

Me këto “reforma” Fuqitë e Mëdha synonin të ruanin *status quo*-n në pjesën europiane të Perandorisë Osmane dhe, duke u dhënë disa të drejta popullsive të krishtere, sllave dhe greke, të parandalonin shpërthimin e kryengritjeve, veprimtarinë e çetave të armatosura dhe mundësinë e një ndërhyrjeje të hapur ushtarake të Serbisë, Bullgarisë, të Malit të Zi e të Greqisë në Rumeli.<sup>1174</sup>

Shpallja e projektit austro-rus të reformave të 21 shkurtit 1903 u prit me pakënaqësi të madhe nga popullata shqiptare, ngaqë te ato shihte drejtpërdrejt rrezikun e copëtimit të ri të vendit. Sepse, zbatimi i këtyre reformave vetëm në vilajetet e Selanikut, të Manastirit dhe të Kosovës, praktikisht sanksiononte copëtimin e vilajeteve shqiptare të Kosovës, të Manastirit, që ndaheshin nga vilajetet e Shkodrës dhe të Janinës. Kjo i shtyri Shqiptarët të ngriheshin kundër projektit austro-rus. Në shumë qytete të Kosovës shpërthyen trazira të mëdha. Më 31 mars 1903, një ushtar shqiptar qëlloi konsullin rus në afërsi të Mitrovicës, ndërkohë që ky i fundit po bënte një vizitë zyrtare në zonë. Dhjetë ditë më vonë konsulli vdiq nga plagët. Më 3 gusht të po atij viti, një shqiptar tjetër vrau konsullin rus, Rostkovski, në Manastir. Këto dy vrasje brenda një harku kohor prej katër muajsh ishin pjesë e

---

<sup>1173</sup> “*Historia e popullit shqiptar*”, pjesa e dytë, Tiranë, 2002. faqe 308.

<sup>1174</sup> Po aty, faqe 308.

shkakut që e detyruan Vjenën dhe Petërburgun të hiqnin dorë nga nxitja e reformave ku shumica e popullsisë ishte shqiptare.<sup>1175</sup>

Shtypi shqiptar në Bukuresht, Sofje dhe qendrat e tjera zuri t'u bëjë jehonë të madhe përpjekjeve të Shqiptarëve që të refuzojnë këtë projekt. Gazeta "*Drita*" e Sofjes, "*Albania*" dhe të tjera ngritën zërin kundër këtyre planeve dhe kërkuan që Fuqitë e Mëdha t'u ktheheshin seriozisht kërkesave të Shqiptarëve për autonominë në përbërje të Perandorisë Osmane, sepse vetëm ashtu rajonit i hiqej rrezikshmëria e krizës dhe çështjet e pazgjidhura viheshin në binarë të zgjidhjeve. Nga frika se rezistenca shqiptare do të mund të mbetej e shkëputur vetëm në vilajetin e Kosovës dhe atë të Manastirit, çka në të vërtetë edhe do të ndodhë, shtypi shqiptar paralajmëronte një lidhje të re shqiptare, e cila do të ishte gjithëpërfshirëse edhe më refuzuese ndaj të gjitha reformave në pjesën europiane të Perandorisë Osmane. Kërkohej që rezistenca shqiptare të kishte për moto kërkesën për autonominë shqiptare, e cila duhej të hynte në pakon e reformave perandorake dhe assesi të përjashtohej prej saj.

Gazeta "*Drita*" e Bukureshtit kërkonte që Shqiptarët ta detyronin Sulltanin që si kundërpërgjigje kërkesave të Fuqive të Mëdha për reformat në vilajetet e Kosovës dhe të Manastirit të emërtuara tashmë si "Maqedoni", t'ua pranonte autonominë, me çka pretendimeve të vendeve sllave do t'u ndalej udha dhe gjendja në pjesën europiane të Perandorisë do të stabilizohej. Këto dhe kërkesat e ngjashme, që përhapeshin në të gjitha anët, të cilave po u shtoheshin edhe ato të qarqeve opozitare nga radhët e Lëvizjes së Xhonturqve që ishte përqendruar në Francë, do të mobilizojnë frymën refuzuese të Shqiptarëve duke e kthyer atë në pjesë të një lëvizjeje, e cila mund të merrte përmasa gjithëkombëtare. Kjo detyroi Sulltanin që të nxjerrë një qarkore, në të cilën u bëhej thirrje Shqiptarëve të nënshtroheshin e të mos ngrinin krye, ndërsa në fund të shkurtit 1903, po për këtë qëllim, u dërguan në Pejë, Gjakovë, në Rekë, në Shkup e në qytete të tjera të Kosovës komisione të posaçme, që kishin për qëllim që reformat e paralajmëruara të shiheshin të dobishme edhe për Shqiptarët, meqë si thuhej, vjelja e taksave, kthimi i rendit dhe i ligjit si dhe hapja e shkollave, ua përmirësonin gjendjen edhe atyre.

Kryeministri Said Pasha, duke bërë fjalë për nevojën e zbatimit të reformave në Shqipëri, mendohej të krijonte përshtypjen se shumica e Shqiptarëve nuk ishin

---

<sup>1175</sup> Gawrich, George: "*Gjysmëhëna dhe shqiponja*", Tiranë, 2007, faqe 205.



kundër reformave se “*përveç disa krerëve, rendin dhe qetësinë në Shqipëri e do shumica e popullsisë, paria dhe të pasurit*”.<sup>1176</sup>

Por, do të shihet se këtë herë, në masë të madhe ishin pikërisht paria dhe të pasurit, ata që refuzonin reformat, të cilat rrezikonin njësoj interesat e tyre, meqë ashtu ata zhvlerësoheshin nga pikëpamja shoqërore dhe ajo ekonomike. Kjo do t’i thuhet haptas edhe kryeinspektorit të Rumelisë, Hilmi Pashës, gjatë një takimi që kishte me parinë e Kosovës si dhe disa nga krerët e lëvizjes kundër reformave. Atij do t’i bëhej me dije se në vilajetet shqiptare kërkohej zbatimi i disa masave me karakter kombëtar, siç ishin njohja zyrtare e kombësisë shqiptare, e drejta e mësimimit dhe e lëvrimimit të gjuhës amtare, futja e saj në ceremonitë fetare, emërimi i nëpunësve Shqiptarë nga njerëzit e aftë, përdorimin e një pjese të taksave të nxjerrra në Shqipëri për ngritjen e shkollave, amnisti për të burgosurit politikë, ndalimi i të huajve që të përziheshin në punët e katër vilajeteve shqiptare etj.<sup>1177</sup>

Kërkesa e fundit, pra ndalimi i të huajve që të përziheshin në punët e vilajeteve shqiptare, në të vërtetë, do të jetë më provokuesja dhe njëherësh më e papranueshmja, sepse mbi të do të bazohen dyshimet e Shqiptarëve se Perandoria tashmë kishte filluar t’i bënte kurban, andaj duhej luftuar kundër çdo pranije të huaj në Kosovë dhe vilajetet tjera shqiptare. Prania e të huajve trimëronte Serbinë, Bullgarinë dhe Greqinë, për të vazhduar rivalitetin e çetave dhe të bandave, në mënyrë që me anën e tyre praktikisht pushtetin osman ta zëvendësonin me atë ndërkom-bëtar, me çka, sipas tyre, përgatitej terreni për përvetësimin e tyre në emër të “realiteteve të krijuara” me reformat.

Në këtë drejtim Shqiptarët më së shumti do t’i brengosë po edhe pezmatojë deri tek shkalla e ngritjes në revoltë dhe kryengritje, prania e konsullatave ruse dhe atyre serbe në Vilajetin e Kosovës dhe atë të Manastirit. Ato, si agjencia të hapura të këtyre vendeve, nxitnin drejtpërdrejt të krishterët, në radhë të parë pakicën serbe, po edhe bullgarët, që në emër të realizimit të të drejtave në përputhje me pikën 23 të Kongresit të Berlinit, të vepronin kundër Shqiptarëve, qoftë duke i provokuar me demonstrimet shoviniste, qoftë duke u shtirur si viktime të tyre dhe të asaj që quhej “*zullum arnaut*”. Kjo shërbente për të alarmuar Portën e Lartë “*për gjendjen e padurueshme të të krishterëve*” si dhe Fuqitë e Mëdha, të cilat tashmë monitoronin me të madhe zhvillimet në pjesën europiane të Perandorisë Osmane dhe gjendjen në të (përkeqësimin apo përmirësimin) kryesisht e vlerësonin në

---

<sup>1176</sup> Po aty, faqe 309.

<sup>1177</sup> Po aty, faqe 309.

përputhje me ankesat e të krishterëve ndaj Shqiptarëve. Kështu që mbi këtë vlerësim pastaj ushtrohej edhe trysni ndaj Perandorisë Osmane, e cila përcaktimin për reformat duhej ta dëshmonte me masat represive që duhej të ndërmernte në vilajetet shqiptare dhe me lëshimet që duhej t'ua bënte të krishterëve, në radhë të parë pakicës serbe, që sa vinin e shtoheshin për të ardhur deri aty sa Sulltan Hamitit t'ua pranojë statusin e plotë të një mileti.<sup>1178</sup>

## KRYENGRITJA E “ILINDENIT” DHE REPUBLIKA E KRUSHEVËS

Lëshimet e mëdha, të cilat, nën trysninë e Ruisë po edhe të aleatëve të saj, që u bëheshin të krishterëve nga ana e Perandorisë Osmane në grahmen e fundit të saj si dhe prania e hapur e bandave serbe, greke dhe bullgare në Kosovë dhe veçmas në Vilajetin e Manastirit si dhe veprimtaria e tyre, sollën edhe rivalitetin e Bullgarëve me atë të Serbëve dhe të Grekëve, të cilët po ashtu kishin planet e tyre për copëtimin e trojeve shqiptare, por edhe përvetësimin e pjesëve të banuara me popullatë të vet, me çka doli në pah ajo që u shfaq si Kriza e Maqedonisë, si çështje politike, ndaj “të drejtës së përvetësimit” të një popullate të retarduar nga shkëputja prej amzës shtetërore bullgare, serbe dhe greke, një si amallgam etnik pa ndonjë vetëdije kombëtare dhe me një gjuhë të afërt me bullgarishten, e ku secila prej tyre pretendonte se është pjesë e saj<sup>1179</sup>.

Te kjo çështje, midis këtyre tri vendeve, nuk kishte dallime në qasje, por në strategji. Sepse, krahasuar me Serbinë dhe Greqinë, që pajtoheshin me ndarjen e Maqedonisë, por që kjo duhej të bëhej në përputhje me qëndrimet e Fuqive të Mëdha dhe *status quo-n*, ku mund të pranohej edhe një Maqedoni autonome, por si kalimtare - Bullgaria shfaqej më e padurueshme. Ajo, tregonte prirje që të shtyjë Fuqitë e Mëdha sa më shpejtë ta qesin në rend të ditës atë që nga Sofja tashmë projektohej si “çështje e maqedonase” në kuadër të hapësirës së vilajeteve të Kosovës, të Manastirit dhe të Selanikut, me shpresë se për këtë kishte mbështetjen e Austro-Hungarisë, po edhe të Ruisë, të cilat kishin interesa të caktuara, që pjesa më e madhe e asaj që ngrihej mbi konceptet gjeografike, t'ua kalonte atyre.

---

<sup>1178</sup> Shih “*Dekretin perandorak*” (irade) të vitit 1903, me të cilin Serbët e pjesës së Perandorisë Osmane fitonin statusin e kombit. Dy vjet më vonë, kjo e drejtë do t'ua njihet edhe vllahëve, ndërkohë që Sulltan Hamiti kur dekretonte hapjen e shkollave në gjuhën serbe dhe vllahe në Kosovë dhe vilajetin e Manastirit, nxori urdhëresën me të cilën ndalote mësimdhënien e gjuhës shqipe nga misionarët amerikanë.

<sup>1179</sup> Cvijić, Jovan: “*O etnografiji Makedonskih Slovena*”, Beograd, 1906, faqe 12-16.

Në përputhje me këtë strategji, Bullgaria urdhëroi komitetet e saj në vilajetet e Kosovës, të Manastirit dhe të Selanikut të vepronin për ta destabilizuar gjendjen. Pikënisje për këtë shfaqej Organizata VMPO „РЕВОЛЮЦИОННАТА ВЪТРЕШНАТА НА МАКЕДОНИЈСКА ОРГАНИЗАЦИЈА“ (*Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase -VMRO*), e themeluar në vitin 1893, e cila, në vitin 1903, mori emrin VMORO “РЕВОЛЮЦИОННАТА ВЪТРЕШНАТА НА МАКЕДОНИЈА-EDRENSKA ОРГАНИЗАЦИЈА”. (*Organizata e Brendshme Revolucionare maqedono-edrenase*).

Qëllimi i kësaj organizate, pavarësisht dualizmit (e brendshme dhe e jashtme), mbe-tej bashkimi i Maqedonisë me Bullgarinë me mjete revolucionare, paçka se pas disfatës së Ilindenit, mjetet revolucionare do t’i zbusë me ato evolucionare, pra me luftë politike, siç do të veprohet nga pas revolucionit xhonturk deri në vitin 1912.<sup>1180</sup>

Në këtë aspekt, pra të ndryshimit të metodave (nga revolucionare te ato politike), janë të njohura përpjekjet kur Komitetet bullgare nga radhët e “*Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedono-Erdenase*” (VMORO), të kërkojnë edhe bashkëpunim me Shqiptarët dhe me Vllahët, në mënyrë që t’i bashkoheshin parullës së tyre “*Maqedonia për maqedonasit*” - që “*si shtet i përbashkët*” i të tre popujve, do t’u shkonte për shtati qëllimeve bullgare.<sup>1181</sup>

Me këtë koncept Bullgaria kërkonte të arrinte dy qëllime politike në përputhje me interesat e saj hegjemoniste. Së pari - të zhvlerësonte vilajetin e Kosovës dhe të Manastirit si vilajete shqiptare dhe të shkëputjes së tyre nga ai i Shkodrës dhe Janinës nga administrimi osman. Dhe së dyti - çështjen maqedonase të ngritur mbi ekzistencën e një etnie të përzier sllave që fliste një gjuhë të ngjashme me atë bullgare, po ku kishte edhe popullatë vllehe dhe greke, që si të përbashkët kishin përkatësinë e krishterimit ortodoks, ku në mënyra konkurruese vepronin kisha pravosllave - greke dhe bullgare, ta kthente në çështje politike, që do të zëvendësonte atë shqiptare. Me këtë synohej pengimi i çfarëdo shteti i pavarur shqiptar ose edhe ndonjë formë autonome e tij pa marrë parasysh si do të shfaqej, të cilin duhej parandaluar, në rast nevojë, qoftë edhe me marrëveshje me Serbinë dhe Greqinë.

Duke shfrytëzuar pakënaqësinë me reformat që kishte shpallur Sulltan Hamiti me rastin e “Udhëzimeve për Rumelinë” dhe krijimin e “megavilajetit” të Rumelisë, që sipas të gjitha gjasave do t’i shkonte për shtati ngritjes së çështjes

---

<sup>1180</sup> Matanov, H, Dimitrov, A dhe Babev, B: “*Historia e Bullgarisë*”, Tiranë, 2006; Ivanoff, I: “*La question macedonienne au point de vue historique, ethnographique et statistique*”, Paris, 1920; Германов, С: “*Европеускеут печат на четите на ВМОРО*”, Велико Трново, 2010.

<sup>1181</sup> Ljuben, L: “*Izveštaji od 1903 na srpskite konzuli, mitropoliti i sveučilišni inspektori vo Makedonija 1875-1012*”. Skopje, 1955; “*Istorija na makedonskijot narod*”, I, Skopje 1969; Glenny, Misha: “*Histori e Ballkanit 1804-1999*”, Tiranë, faqe 203-205.

shqiptare ngaqë shumica e popullatës vlerësohej se kishte prejardhje shqiptare dhe vllahe, dhe të shtyrë nga frika se mos reformat mund të shkojnë në dëm të Bullgarisë, Komitetet e shumta bullgare-maqedonase në rrethet e Ohrit, Kosturit dhe Serezit, të shtyrë nga “Komitetet e jashtme”, pra nga ato që mbikëqyrshin drejtpërdrejt nga Bullgaria dhe të frymëzuara me parullat “*Liri a vdekje*” dhe “*Maqedonia për maqedonasit*”, që bekoheshin nga kleri bullgar eksarkist dhe fushata e tij e ashpër rreth kësaj çështjeje, në pranverën e vitit 1903, u ngritën në një kryengritje kundër garnizoneve osmane në atë pjesë, por që me të shpejtë u kthye në një luftë që komitetet bullgarë zhvilluan kundër popullatës shqiptare të besimit mysliman të asaj pjese me qëllim që t’i humbej tërësia etnike e tyre. Më 2 gusht të vitit 1903, në ditën e Shën Ilisë ajo do të shpërthejë edhe në Manastir. Po në këtë ditë në periferi të qytetit të Krushevës, ku u shpall e ashtuquajtura Republikë e Krushevës, kryetar i së cilës u zgjodh Nikolla Karev, komandant i kryengritësve në këtë qytet.<sup>1182</sup>

Më pas, gjithnjë në formën e një lufte, që komitetet bullgarë bënë kundër katundeve të myslimanëve, kryengritja u shtri në disa pjesë të Trakisë, në vilajetin e Selanikut dhe, e mbikëqyrur nga Bullgaria dhe interesat e saj në të, vijoi tre muaj, deri në fund të tetorit, kur edhe u shtyp nga ndërhyrja e fuqishme e Portës së Lartë, e përcjellë me masa të ashpra hakmarrjeje ndaj popullatës së krishterë ortodokse nën mbikëqyrjen e ekzarkatit bullgar të kësaj pjese e cila u përfshi në anën e komitëve.

Historiografia shqiptare, përkundrazi, vlerëson se Kryengritja e Ilindenit u përkrah nga popullsia shqiptare e trevave lindore të Krushevës dhe rrethinës së saj, duke ngatërruar këtu vllahët (të lidhur me Bullgarinë, që faktikisht ishin pjesëmarrës në strukturat kryengritëse) me shqiptarët ortodoksë (një pjesë e tyre, po ashtu, të lidhur me kishën bullgare për të shpëtuar nga kisha sllave dhe ajo greke) dhe duke anashkaluar manipulimin popullatës së kësaj pjese nga Bullgaria, po edhe Serbia dhe Greqia, dhe qëllimet e tyre politike kryesisht mbi baza fetare.<sup>1183</sup>

I kësaj natyre është edhe vlerësimi se “atdhetarët shqiptarë të Manastirit, të Prespës, të Strugës, të Pogradecit dhe të qendrave të tjera, furnizuan çetat maqedonase me armë e municione”, dhe se kryengritja u përkrah edhe nga popullsia shqiptare e Shkupit, Tetovës, Gostivarit, Dibrës dhe Strugës.<sup>1184</sup> Ndonëse nga shumë burime bëhet e ditur se do të jenë pikërisht një pjesë e mirë e redifëve

---

<sup>1182</sup> Po aty.

<sup>1183</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 311.

<sup>1184</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, II, Tiranë, 2002, faqe 311.

nga këto anë, kryesisht shqiptarë të besimit myslimanë, që do të angazhohen për shtyrjen e kryengritjes nga shkakut se ajo prekte interesat e tyre.<sup>1185</sup>

Por, këto dhe fakte të ngjashme, nuk do ta pengojnë atë pjesë të historiografisë shqiptare, që në përputhje me platformën ideologjike, kryengritjen e Ilindenit ta shohë një “organizatë revolucionare të tre popujve – Maqedonasve, Shqiptarëve dhe Vllehëve”,<sup>1186</sup> ndonëse kjo përjashtohet fare nga historiografia bullgare, e cila e sheh vetëm si kryengritje bullgare në Maqedoni.<sup>1187</sup>

Por, Ilindenin si organizatë të “tre popujve”, kuturu nuk e pranon as historiografia maqedonase, e cila, për ta nxjerrë kryengritjen nga pronësia bullgare si dhe konceptet që ia imponoi asaj gjatë gjithë kohës duke e parë si lëvizje bullgare, përpiket vazhdimisht pjesëmarrjen e vllehëve dhe të shqiptarëve, e sheh në rolin e pakicave, pra në përputhje me platformën e Maqedonisë së dalë nga koncepti i AVNOJ-it, që duhet të vlejë si “model” për shtetin maqedonas “me pakicat”.<sup>1188</sup>

Ngjashëm sillet edhe historiografia jugosllave e ndikuar nga ajo serbe, e cila, për të eliminuar faktorin bullgar dhe rolin kyç në këtë kryengritje si dhe zhvillimet e gjithëmbarshme që përcollën krizën e Maqedonisë, sheh “sllavo-maqedonas”, me ndonjë vllah e asnjë shqiptar.<sup>1189</sup>

Ndërsa, shqiptarët, “e përfaqësuar” në të ashtuquajturën “Republikë e Krushëvës”, mungojnë fare në burimet ndërkombëtare.<sup>1190</sup>

Natyrisht se “argument” për këtë “multietnicitet” të “Ilindenit”, që megjithëqë historiografia botërore, të shumtën e vlerëson si lëvizje bullgare, shfaqet përherë vetëm “*Manifesti i Krushëvës*”, të cilit me të drejtë i kontestohet autenticiteti, nga shkakut se versioni “i plotë” rrodhi nga një proklamata e Kominternit e viteve të tridhjeta.

---

<sup>1185</sup> Shih: Hubka, Gustav: “*Die österreichisch-ungarische offizirenmission in Makedonien 1903-1909*”, Wiena, 1910; Jagic, D: “*Das Macedonischen Problem*”, 1903; Schwertfeger, Bernhard “*Die Diplomatischen Akten des Auswärtigen Amtes 1871-1914*”, Teil 1-5 (Band 1-39), Berlin 1927-1928.

<sup>1186</sup> Rahimi, Shukri: “*Format e rezistencës së popullit shqiptar kundër sundimit turk gjatë viteve 1900-1903 dhe karakteri i tyre*”, “Përparimi”, Prishtinë, 1962, nr. 4. faqe 212.

<sup>1187</sup> “*История в България*”, Софија, 1981; Василев, В. А; Божин Војнов: „*Българската Просвета в Македонија и одридска Тракија 1878-1913*“, 1982; Guechoff, Iv E: “*L’Alliance Balkanique*”, Paris, 1915.

<sup>1188</sup> “*Историја на Македонски Народ*“, Skorje, 1969; Pandeovski, Manol: “*Makedonija na Balkanot*”, Skorje, 1990; Zografski, Danco: “*За македонското прашање*“, Skorje, 1990; Зографски, Д: “*Крушевката Република*“, Shkur, 1948; Симоновски, Т: „*Книжа за Илinden*“, 1969; Jagic, D: “*Das Macedonischen Problem*”, 1903.

<sup>1189</sup> *Istorija Naroda Jugoslavije*, Beograd, 1963. Božić, J: „*Istorija Jugoslavije*”, Beograd, 1973.

<sup>1190</sup> Nikolaides, Clenates: “*La Macedonia*”, Berlin, 1899; Richard, Crampton: “*Bulgaria 1878-198: A History*”, Boulder, 1983; Hubka, Gustav: “*Die österreichisch-ungarische offizirenmission in Makedonien 1903-1909*”, Wiena, 1910; Hösch, Edgar: „*Geschichte der Balkanländer: Von der Frühzeit bis zur Gegenwart*”, München, 1995; Brailsford, H. N: “*Macedonia: Its Races and their Future*”, London, 1906; Fikret, Adanir: “*Die Makedonische Frage: Ihre Entstehung und Entwicklung bis 1908*”, Wiesbaden, 1979.

Sidoqoftë, me apo pa këtë proklamatë të sajuar për qëllime propaganduese, kryengritja e “Ilindenit” dhe gjithë ajo që doli prej saj, duhej t’i jepte legjitimitet politik një lëvizjeje në pjesën evropiane të Perandorisë Osmane, me të cilën, krahas interesave të Bullgarisë, Serbisë dhe Greqisë që të përvetësonin sa më shumë nga pjesa e saj, Rusia do të arrinte dy qëllime njëherësh. Në njërën anë të pengonte Lëvizjen kombëtare shqiptare në zhvillim e sipër, për një autonomi shqiptare brenda Perandorisë Osmane, me të cilën do t’i krijoheshin themelet shtetit të ardhshëm shqiptar, që shfaqej edhe si opsion i pashmangshëm i Austro-Hungarisë, Italisë e Gjermanisë në përputhje edhe me interesat e tyre. Dhe, në tjetrën anë, të fuste në lojë idenë e vendimeve të Shën Stefanit për Bullgarinë e Madhe në këtë pjesë në përputhje me interesat e saj, e ku nuk do të harroheshin edhe aleatët e tjerë: Serbia, Mali i Zi dhe Greqia, që do të merrnin pjesë në “plaçkën” e etnisë shqiptare, por gjithnjë sipas kutit rus.

Po ashtu, në planin ballkanas, në përputhje me interesat e vendeve ortodokse si dhe strategjinë e tyre për copëtimin e trojeve shqiptare, propaganda rreth “kryengritjes së përbashkët maqedonase”, kishte për qëllim edhe krijimin e një klime politike në dëm të çështjes shqiptare, me ç’rast, shqiptarët duke u bërë pjesë e skenarëve mbi baza fetare (atyre ortodokse të drejtuar nga ekzarkati bullgar, po ku nuk përjashtohej edhe ndikimi i kishës pravosllave serbe dhe asaj greke i pasqyruar në fazat e mëvonshme), të përplaseshin ndër veti kundër interesave, që kishte proklamuar Rilindja kombëtare.

Pavarësisht interpretimeve të ndryshme si dhe realiteteve politike që dolën prej saj, kryengritja e “Ilindenit”, ndonëse jo në përmasat e asaj që pati gjatë revolucionit grek të viteve të njëzeta midis shqiptarëve ortodoksë (arvanitasve) dhe atyre të besimit myslimanë, që u kurorëzuar me formimin e shtetit grek në dëm të shqiptarëve,<sup>1191</sup> përçau etninë shqiptare dhe krijoi rrethanat për një luftë vëllavërasëve midis shqiptarëve. Ndodhi kështu ngaqë, në njërën anë, një pjesë e shqiptarëve ortodoksë, e përfshinë si “vullnetarë” në kuadër të “komiteteve popullore mbrojtëse”, të rekrutuar nga kisha ortodokse bullgare (ekzarkati) dhe interesat hegjemoniste bullgare në këto njësi, nën komandën e komitëve bullgarë, u drejtuan kundër katundeve shqiptare në pjesën e Resnjës dhe të Manastirit. Dhe, në tjetrën anë, shfaqen shqiptarët e besimit myslimanë, në kuadër të armatës

---

<sup>1191</sup> Edhe Revolucionit grek të vitit 1822 i priu një “Manifest” – ftesë, i njohur si “Manifesti i Odesës”, nga Ypsilanti dhe qarku revolucionar, me ç’rast Shqiptarëve të krishterë të Greqisë u bëhej ftesë të merrnin pjesë në revolucionin antiosman, me të cilin “do të krijohesh shteti i përbashkët grek”, që siç u pa, doli shtet i mbështetur mbi hegjemonizmin helen mbi moton “kush është grek është ortodoks, dhe kush është ortodoks është grek”.

osmane, si redifë ose vullnetarë, për t'i mbrojtur katundet që sulmoheshin nga komitetë që drejtoheshin nga bullgarët, por edhe për t'i çliruar ato të pushtuara prej tyre nga ditët e para të kryengritjes.<sup>1192</sup>

Andaj, nga këndvështrimi shqiptar dhe të interesave të tyre vitale, kryengritja e “Ilindenit”, e dirigjuar nga Rusa dhe Bullgaria dhe shërbimet e tyre ushtarake, ndonëse e zhvilluar nën moton politike “Maqedonia maqedonasve”, si formulë që është përkrahur edhe nga Serbia dhe Greqia për interesat e tyre, ka prodhuar pasoja të dëmshme për Shqiptarët dhe çështjen e tyre në shumë drejtime.

## KRIZA E MAQEDONISË DHE NDËRHJRJA NDËRKOMBËTARE

Kryengritja e “Ilindenit” dhe shuarja e saj, megjithatë, krahas përpjekjeve që çështja shqiptare, me ngritjen artificiale të çështjes maqedonase, si një projekt sllavo-ortodoks, të anashkalohej ose të zhdukej fare, nxori në pah një zhvillim tjetër që, së paku për një kohë të caktuar, rrënoi marrëveshjet joparimore midis vendeve ballkanike (Serbisë, Bullgarisë dhe Greqisë), dhe theu baraspeshën rajonale, që ishte mbështetur mbi këta faktorë dhe për një kohë i kishte dhënë njëfarë ngjyrimi të përbashkët trysnisë që do t'i bëhet Perandorisë Osmane për ta detyruar atë që të ndërhyjë Fuqitë e Mëdha në të për të vënë mbikëqyrje të plotë mbi të në përputhje me qëllimin që mandati ndërkombëtar në vilajetin e Kosovës, atë të Manastirit dhe të Selaniku do të paraqesë fazën kalimtare për ndarjen e saj hapësire, midis këtyre tri shteteve ballkanike.

Fjala ishte për përpjekjet e Portës së Lartë që me anën e Grekëve dhe *andarëve*<sup>1193</sup>ta përçajë nga brenda lidhjen sllavo-ortodokse, veçmas atë bullgare, rreth “komplotit” të përbashkët kundër Maqedonisë duke i kundërvënë me njëri tjetrin aleatët e deridjeshëm, që bënë plane për copëtimin tokave shqiptare në të. Kështu, pasi që njësitë e bashibozukëve të kenë asgjësuar komitetet dhe çetat bullgare nga komitetet “e brendshme” dhe “të jashtme”, duke marrë me vete plaçkën e madhe dhe duke lënë pas edhe rrënimet e mëdha, kryeinspektori i Rumelisë, Hilmi Pasha, pas udhëzimeve nga Stambolli, lejoi futjen e *andarëve* grekë në Maqedoninë

---

<sup>1192</sup> Schwertfeger, Bernhard “Die Diplomatischen Akten des Auswärtigen Amtes 1871-1914”, Teil 1-5 (Band 1-39), Berlin 1927-1928 dhe Prifti, Kristaq: “Doktor Ibrahim Temo”, Prishtinë 1996, faqe 195-199.

<sup>1193</sup> Fjala është për njësi të armatosura greke, që paguheshin për shërbimet e tyre, të cilat një kohë u toleruan edhe nga Perandoria Osmane.

Perëndimore. Ata morën përsipër sigurinë në këtë pjesë. *Andarët* bënë që bashkësitë e Eksarkisë bullgare të ktheheshin te Patrikana me çka praktikisht në këtë pjesë do të rivendoset pushteti i Grekëve, i cili nga viti 1870 u ishte marrë në sajë të vendimit të Portës së Lartë që të njohë legjitimitetin e kishës bullgare, që për pasojë pati që popullata sllavo-maqedonase e këtyre anëve t'i bashkëngjitet ndikimit bullgar duke iu nënshtruar kështu ideve bullgaromëdha, të cilat, Perandoria Osmane, asokohe i kalkuloi për hesape të veta në raport me tryshninë që i vinte nga Serbia dhe Greqia për copë-timin e vilajeteve europiane.

Pas shuarjes së “Ilindenit” Perandoria Osmane sërish ktheu topin kah grekët, kundër bullgarëve, duke futur në lojë kartën fetare, pra kishat, si faktor të rëndësishëm për “qërim të ndërsjella të hesapeve”, që u shkonin për shtati osmanëve. Kështu, Patriarkana greke, mori përsipër hakmarrjen kundër bullgarëve mbi baza kishtare. Ndaj, aty ku nuk pranohej pushteti i Patrikanës, Grekët u sollën si tiranë hakmarrës, duke ekzekutuar ata që dyshoheshin si renegatë e duke detyruar, nën tytat e armëve, që mesha në kishë të mbahej sipas variantit të patrikanës, kur prifti ose banorët nuk donin që shërbesa të kryhej ashtu.<sup>1194</sup>

Kjo kundërgoditje nga ana e Grekëve drejtohej nga despoti armëmadh i Kosturit Germanos Karavangjelis. Karavangjelisi që i bindur se lufta ndërmjet Patrikanës dhe Eksarkisë nuk bëhej aspak për arsye fetare – ai pohonte hapur se e vetmja çështje për Maqedoninë ishte harta e ardhshme e shteteve të Ballkanit, sapo të dëboheshin Osmanët.<sup>1195</sup>

Me rrudhjen dhe pothuajse shuarjen e rolit të Komiteteve bullgare të përfshira në “*Organizatën e Brendshme Revolucionare të Maqedonisë*” (VMRO), do të ndryshon edhe politika serbe, e cila tashmë do të heqë dorë nga përcaktimi i mëparshëm i pranimi të “Maqedonisë federative” me karakter sllav, me të cilin pengohej krijimi i vilajetit të përbashkët shqiptar dhe shtetit të ardhshëm shqiptar brenda Perandorisë Osmane, duke iu kthyer strategjisë së luftës së hapur për ndikim territorial e kishtar jo vetëm kundër Grekëve e bullgarëve, por edhe kundër Shqiptarëve dhe Turqve.

Meqë Beogradi tashmë e kishte të qartë se projekti i “Maqedonisë federative”, pra të një konstruktiv artificial politik për destabilizim të pjesë së evropiane të Perandorisë Osmane, kishte dështuar dhe ai më nuk shfaqej si opsion as për Perandorinë Osmane e as për Fuqitë e Mëdha, do të lëshohet në luftën e brendshme

---

<sup>1194</sup> Glenny, Misha: “*Histori e Ballkanit 1804-1999*”, Tiranë, 2007, faqe 206.

<sup>1195</sup> Po aty, faqe 206.



për të përfituar sa më shumë në atë që tashmë në kancelaritë evropiane quhej “Maqedoni”, duke luajtur me kartën e dyfishtë: të Vjenës dhe të Petërbergut. Serbia, pra, kërkonte që Austro-Hungarisë dhe Rusisë t’u lihej e hapur rruga e lidhjeve me to në bazë të asaj se kush i ofronte më shumë në Maqedoni. Por, që të vijë deri te ky çmim, Beogradi do të drejtohet të shfrytëzojë diplomacinë: duke u pajtuar me reformat e Fuqive të Mëdha, dhe po ashtu do të shfrytëzojë edhe mundësitë që të prodhojë sa më shumë që të jetë e mundur krizë në vilajetet e Kosovës dhe të Manastirit me anën e futjes së bandave dhe ndezjes së konfliktit me Shqiptarët, po edhe me të tjerët për ta zhvendosur atë sa më shumë që të jetë e mundur nga dimensionimi i çështjes së kërkesës së Shqiptarëve për autonomi brenda Perandorisë Osmane, tek problemi i mbrojtjes së Serbëve në të, në përputhje me dekretin e Sulltan Hamitit që Serbëve t’u njihej statusi i *miletit* (kombit) në pjesën europiane të Perandorisë, gjë që pas njohjes së të drejtës së gjuhës amtare dhe të hapjes së mitropolisë ortodokse serbe në Prizren dhe Shkup<sup>1196</sup>, ata kërkonin që Kosovës t’i pranohej edhe statusi i “*Serbisë së vjetër mesjetare*”.

Se kjo synohej, mund të shihet më së miri nga një urdhër që Nikolla Pashiq, kryeministër i Serbisë, ua lëshoi përfaqësuesve diplomatikë të Serbisë ku, pos tje-rash thuhej:

*“Të mbrojmë bashkatdhetarët tanë nga pasojat e dëmshme të monopolit të organeve të Patrikanës, të cilat janë vënë në shërbim të helenizimit, në dëm të përkrahësve jogrekë të kishës patrikane; dhe t’i kundërvihen veprimtarisë së agjentëve të Eksarkisë, komitetet e së cilës po na dalin me armë në krahinat me interes të madh për ne: Poreç, Kërçovë, Drimkol, Dibër dhe Qypri!”*<sup>1197</sup>

Prandaj shtypja e kryengritje së “Ilindenit” nuk kishte mundur të shuajë luftën nacionaliste. Përkundrazi, e kishte thelluar. Lufta po vinte duke u përhapur, por tash me një ekuilibër të ndryshuar. Sikundër despoti Karavangjelis, qeveria e Stambollit si më të rrezikshëm quante veprimtarinë kryengritëse të bullgarëve. Komitetë grekë e serbë në qendër të luftës së tyre vunë shuarjen e ndikimit të bullgarëve ose Shqiptarëve, ose të njëri-tjetrit – kurse forcave Osmane nuk u krijuan shumë andralla. Madje, komitetë e krishterë deri-diku kishin uzurpuar rolin e shtetit për të mbrojtur rendin brenda territorit.<sup>1198</sup>

<sup>1196</sup> Statusi i plotë i *miletit* (kombit) Serbëve të pjesës europiane të Perandorisë Osmane, do t’u njihet nga Sulltan Hamiti me dekretin (*irade*) e vitit 1903, ndërsa ai i gjuhës amtare dhe i rikthimit të mitropolive ortodokse serbe në Prizren dhe Shkup do të bëhet me dekretin perandorak të vitit 1886.

<sup>1197</sup> Glenny, Misha: “*Histori e Ballkanit 1804-1999*”, Tiranë, 2007, faqe 207.

<sup>1198</sup> Po aty, faqe 208.

Që ky ekuilibër i forcave të dukej ndryshe nga ç' ishte, do të përkujdeset Porta e Lartë me futjen e Patrikanës aty ku më parë Eksarkati bullgar për tridhjetë e tri vjet ia kishte dalë që të ndryshonte përcaktimin e popullatës sllavo-maqedonasenga ndikimi grek te ai bullgar, gjë që do të detyrojë edhe qëndrimin e Serbisë, e cila do të jetë shumë e kënaqur që Bullgaria ishte sjellë para situatës që të humbte hapësirën e ndikimit nga Grekët, me të cilët Beogradi e kishte shumë më lehtë t'ia dilte mbanë, nga shkaku se popullata sllavo-maqedonase, po qe se do të detyrohej të përcaktohej midis pushtimit grek apo serb, atëherë më me dëshirë vendoste për atë serb, meqë lidhjet gjuhësore dhe kishtarë midis këtyre popujve ishin më të afërta se sa me Grekët, siç kishin edhe një varg interesash të tjera të përbashkëta.<sup>1199</sup>

Mirëpo, dhuna e ushtruar ndaj kryengritësve nga autoritetet osmane si dhe kthimi i mandatit të Patrikanës greke në dëm të Ekzarkatit, me çka rrënoheshin balancimet rajonale, shpejtoi ndërhyrjen e Fuqive të Mëdha, sidomos të Austro-Hungarisë dhe të Ruisë, të cilat kishin mandatin ndërkombëtar për Ballkanin.

Në shtator e tetor 1903, cari Nikolla II dhe perandori Franz Jozef u mblodhën me ministrat e tyre, për të formuluar një politikë, që do të garantonte *status quo-n* në atë që tashmë njihej si Maqedoni ndonëse në Perandorinë Osmane njiheshin si vilajet i Kosovës dhe i Manastirit. Rezultati që Marrëveshja e Myrsteget (Mürzsteg – rezidencë mbretërore në afërsi të Vjenës) ku pika kryesore ishte plani për riorganizimin e xhandarmërisë osmane në Maqedoni, të cilat shoqëroheshin edhe me disa masa të tjera përcjellëse, që merreshin përsipër nga fuqitë europiane. Ky plan do të vihej në jetë nga policë profesionistë, të dërguar prej Fuqive të Mëdha, të cilët do të komandonin këtë forcë si dhe merrnin përsipër rekrutimin e njësisve të reja, ku do të futeshin edhe policë nga popullata e krishterë.<sup>1200</sup>

Në këtë marrëveshje po ashtu parashihej që inspektori i përgjithshëm, Hysen Hilmi Pasha, të “përforcohej” me dy nëpunës të lartë civilë, një rus dhe një austriak, që do të vëzhgonin zbatimin e reformave dhe gjendjen në atë që nga fuqitë e mëdha tashmë njihej si Maqedoni dhe për vendimet e plotfuqishme ata kishin fjalën kryesore. Vjena dhe Petërsburgu vinin nën mbikëqyrje e tyre vilajetet e ashtuquajtura “maqedonase” të Kosovës, të Manastirit dhe të Selanikut. Në këtë marrëveshje do të kërkohet edhe çarmatosja e popullatës.

Ndërkaq, për të shmangur një ashpërsim të mëtejshëm të kundërthënieve ndërmjet Fuqive të Mëdha, territori në të cilin do të zbatoheshin reformat u nda në

---

<sup>1199</sup> Cvijić, Jova: “O Etnografiji Slovenskih Makedonaca”, Beograd, 1906, faqe 12-18.

<sup>1200</sup> Schwertfeger, Bernhard “Die Diplomatischen Akten des Auswärtigen Amtes 1871-1914”, Teil 1-5 (Band 1-39), Berlin 1927-1928.

5 zona (të Serezit, të Dhramës, të Selanikut, të Shkupit dhe të Manastirit), në çdo njërin prej të cilëve u vendosën respektivisht oficerët e huaj, francezë, anglezë, rusë, austriakë dhe italianë.<sup>1201</sup>

Kjo ishte hera e parë që një “forcë ndërkombëtare”, me anëtarë nga Fuqitë e Mëdha kryesore, vendosej për të qetësuar trazirat e brendshme në Ballkan e për të vepruar në interes të Fuqive të Mëdha.<sup>1202</sup>

Ajo që ishte e dukshme në këtë marrëveshje dhe do të ketë ndikim në zhvillimet e ardhshme drejt një qorrsoaku, kishte të bënte me faktin se Porta e Lartë po e humbte autoritetin e vet, ndërkohë që Sulltani tashmë luante rolin e një vasali të Fuqive të Mëdha, duke u përpjekur që të fitonte nga kontradiktat e tyre në dëm të sovranitetit shtetëror që tashmë ua kishte dorëzuar të huajve. Se tashmë ndodhej në këtë gjendje Sulltan Hamiti do të bindet përfundimisht kur për herë të parë po lihej pa alternativë: të nënshkruante, ose të përballej me zemërimin e Fuqive të Mëdha. Golluhovski pranonte se programi i Myrstegut përbënte një ndërhyrje të drejtpërdrejtë të Austro-Hungarisë e të Rusisë në pjesën europiane të Perandorisë Osmane. Kjo bëhej që të ruhej *status quo* në Ballkan dhe të sigurohej një zgjidhje paqësore e problemeve të kësaj pjese. Ministri i punëve të jashtme të Austro-Hungarisë deklaroi se këto dy fuqi nuk synonin të vendosnin ndonjë ndikim mbi-zotërues këtu, por në të njëjtën kohë nuk do të lejonin që një gjë të tillë ta bënte ndonjë shtet tjetër. Më 25 nëntor 1903, Sulltan Hamiti e pranoi siç quhej Marrëveshjen e Myrstegut. Pikat kryesore të projektit të Myrstegut kanë qenë:

*-Emërimi i një inspektori me dy agjentë të Kontrollit European;*

*-Riorganizimi i xhandarmërisë dhe i krahinave reformuese që të ndahen në zona më të vogla;*

*-Të bëhen ndryshime në ndarjen administrative të Turqisë europiane, që në mënyrë të drejtë të bëhet grupimi i kombeve të ndryshme;*

*-Riorganizimi i organeve shtetërore dhe gjyqësore, sigurimi i pjesëmarrjes së krishterëve dhe i myslimanëve në organet shtetërore;*

*-Riorganizimi i organeve shtetërore dhe administrative të bëhet në frymën e autonomive lokale;*

*-Në gjyqet kryesore administrative të vendosen komisionet e përziëra anketuese prej myslimanëve dhe të krishterëve, të cilët kanë pasur për qëllim t'i shqyrtonin gabimet politike nën kontrollin rus dhe austro-hungarez;*

---

<sup>1201</sup> Hubka, Gustav: “Die österreichisch-ungarische offizierenmission in Makedonien 1903-1909“,Wiena, 1910 dhe “Historia e Popullit Shqiptar”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 313.

<sup>1202</sup> Glenny, Misha: “Histori e Ballkanit 1804-1999” Po aty, faqe 206.

*-Pushteti osman t'i kompensojë dëmet e bëra në kohën e terrorit dhe të represalieve të ushtrisë turke kundër lëvizjes kryengritëse shqiptare dhe asaj maqedonase. Dëmet e bëra duhej t'i përcaktonin komisionet e përziera;*

*-Lirimi i të krishterëve prej pagimit tatimor për një vit;*

*-Porta e Lartë të ndërmarrë masa për kthimin e emigrantëve dhe rindërtimin e shtëpive të tyre në katunde;*

*-Lëshimi i rezervistëve të thirrjes së parë të çetave të rregullta dhe ilaçeve (thirrja e tretë - bashibozukët) dhe Qeveria Osmane të njihet me të gjitha masat dhe kërkesat paraprake në notën e shkurtit dhe me Projektin e Myrstegut dhe t'i zbatojë pa kurrfarë shtyrje.<sup>1203</sup>*

Programi i reformave të Myrstegut parashihte formimin e dy komisioneve të kontrollit: njëri t'i mbikëqyrte organet e pushtetit në zbatimin e reformave, dhe i dyti ishte komisioni i riorganizimit të xhandarmërisë, në të cilin duhej të marrin pjesë të gjitha fuqitë reformuese. Sipas nenit 1 të Programit parashiheshin të drejtat e agjentëve civilë që ishin: Henri Riter dhe Müller von Roghei nga ana e Austrisë (i pari ishte këshilltar zyrtar i jashtëzakonshëm në Ministrinë e jashtme në Odesë, dhe nga ana e Rusisë, Nikolla Demerniku.<sup>1204</sup>

Më 30 dhjetor 1903 Sulltani me dekret e pranoi De Gjergjisin për komandant të xhandarmërisë.<sup>1205</sup> Me të u pajtua edhe Gjermania.<sup>1206</sup>

Ky mision i hapi rrugën një tradite të gjatë të ndërhyrjeve pa sukses të Fuqive të Mëdha në pjesën europiane të Perandorisë Osmane, ndërhyrje kjo që në forma të ndryshme, së paku sa i përket çështjes shqiptare, në disa aspekte të saj, do të mbesë e tillë për të ardhur edhe deri në kohën tonë.

Sidoqoftë, projekti austro-rus i reformave dhe përgjithësisht ndërhyrjet e huaja në territoret shqiptare, i dhanë një shkas tjetër lëvizjes kryengritëse në Shqipëri, veçmas në vilajetin e Kosovës dhe atij të Manastirit. Shqiptarët u ngritën përsëri kundër reformave, sepse ato u përcollën edhe me vendosjen e taksave të reja që Porta e Lartë vendosi për t'i përballuar shpenzimet e shumta dhe po ashtu u përcollën edhe me vendimin për çarmatosjen e popullatës malore, gjë që kjo shkaktoi mlllef të dyfishtë.

---

<sup>1203</sup> L. Bittner: "Chronologisches Verzeichnis der Österreichischen Staatverträge", vëllimi III, Wien, 1914, faqe 526.

<sup>1204</sup> Ruchti, Jacob: "Die Reformaktion Österreich-Ungarns und Russlands in Mazedonien 1903-1908", Gotha, 1918, faqe 2.

<sup>1205</sup> Po aty, faqe 3.

<sup>1206</sup> A. Geschke: "Die Deutsche Politik in Macedonischen Frage bis zur Türkischen Revolution von 1908", Danzing, 1932, faqe 77.

Në pjesë të ndryshme të Kosovës shpërthyen kryengritje, të cilat për shumë kohë, mbetën të shkëputura dhe pa ndonjë qendër të përbashkët organizimi, ndër-kohë që në vilajetin e Manastirit lëvizja shqiptare zuri t'u përshtatet rrethanave të veprimeve klandestine (ilegalitetit), të organizimit në çeta dhe grupe të ndryshme revolucione që ia kishin imponuar Serbët, Bullgarët dhe Grekët.

Ishte ky një moment i ri që asaj do t'ia shtojë “mundësitë” e veprimit, por do t'ia humb unitetin dhe legalitetin kërkesave për autonominë shqiptare në kuadër të Perandorisë, duke i ngatërruar me mjegullimin e atyre “çlirimtare”, që rëndom ishin në përputhje me interesat e fqinjëve të tyre, (Serbisë, Malit të Zi, Greqisë dhe Bullgarisë), ku motoja e luftës “çlirimtare” nuk nënkuptonte tjetër pos që të krijoheshin rrethanat që viset shqiptare të shkëputeshin nga etnia e tyre dhe t'u bashkoheshin dhunshëm atyre, siç do të ndodhë në të vërtetë pas Luftërave të Para Ballkanike.

Megjithatë, në Kosovë, ku çdo gjë do të vazhdojë në përputhje me konceptin e lëvizjeve të mëdha popullore, të shfaqura për herë të parë nga “Lidhja Shqiptare e Prizrenit” për t'u vazhduar deri te “Lidhja e Pejës”, e drejtuar nga patrioti Haxhi Zeka, këtë herë, epiqendra e tyre ishte Gjakova dhe ato u drejtuan nga Sulejman Batusha. Me disa qindra kryengritës sulmoi garnizonin e ushtrisë osmane në qytet, por nuk ia doli ta marrë. Kryengritja pastaj u përhap edhe në Pejë, Lumë, Rekë e shkoi deri në Mitrovicë. Me rënie dhe ngritje ajo vazhdoi gjatë gjithë pranverës dhe verës së atij viti. Në shtator, sa nga ofensiva e forcave Osmane të drejtuara nga Shemsi Pasha, i njohur për ndërhyrje ushtarake në vilajetin e Kosovës, e sa nga një marrëveshje që u arrit midis valiut të Kosovës, Shaqir Pashës me disa nga drejtuesit e kryengritjes, ajo thujse u shua. Mbetën disa vatra të hapura të rezistencës, të cilat lenin për të kuptuar mospajtimin e Shqiptarëve me reformat.

Edhe pse kryengritjet e Shqiptarëve të viteve, 1903-1904 nuk ishin të një intensiteti gjithëpërfshirës dhe nuk u sollën gjithaq telashe forcave osmane të shpërndara enkas në vilajetet shqiptare që të mundësonin zbatimin e reformave që ishin pranuar nga Sulltani dhe ato paraqitnin ndërhyrjen e parë ndërkombëtare të kësaj natyre në vilajetet shqiptare dhe ato përreth tyre, megjithatë, prania ndërkombëtare për herë të parë drejtpërdrejt do të tregojë përvijimet e sferave të interesit në këtë hapësirë.

Austro-Hungaria do të përqendrohet tek pjesët shqiptare dhe aty do të drejtojë përkujdesjen e vet, ndërsa Rusia do të përqendrohet në pjesët sllavo-maqedonase. Këtu, po ashtu, për herë të parë, do të dalin në pah edhe interesat italiane, që do të

jenë afruese me ato ruse kur bëhej fjalë për zvogëlimin e ndikimit të Vjenës në hapësirën shqiptare dhe ato franceze me nuansime proserbe dhe britanike si progreke.

Gjermanët do të tregohen “fare parimor”, që në emër të ruajtjes së *status quo-s* në rajon, shfaqnin interesim për stabilitetin e Perandorisë Osmane, meqë kishin hesapet e tyre ekonomike, ndërkohë që edhe me zbatimin e reformave në hapësirat europiane të saj, aleati i tyre Austro-Hungaria, forconte ndikimin e vet veçmas duke e shtrirë atë në vilajetet shqiptare, mbikëqyrja e të cilave paraqitej pjesë e preokupimeve të saj strategjike.<sup>1207</sup>

Në këtë frymë, i shtyrë nga ndikimi austro-hungarez, që problematika shqip-tare të veçohej nga reformat, ose që të gëzonte një tretman autokton, Komisioni Ndërkombëtar Ushtarak, i ngarkuar për të caktuar territoret ku do të zbatoheshin reformat, shqyrtoi çështjen e organizimit të *një sanxhaku shqiptar në Vilajetin e Kosovës*, i cili do të përjashtohej nga zona e reformave dhe do të përbëhej nga rrethet ku Shqiptarët përbënin shumicën dërmuese të popullsisë, pjesë kjo që do të shtrihej nga Kaçaniku në jug e deri në Kollashin në veri, duke përfshirë edhe Pazarin e Ri e Plevlën. Këtë propozim e bëri atasheu ushtarak i Austro-Hungarisë, baroni Gizelli<sup>1208</sup>

Organizimi i një sanxhaku shqiptar në Vilajetin e Kosovës e shqetësoi shumë Serbinë. Pas protestave të ashpra që Serbia do t’ia dërgojë Ruisë, përfaqësuesi i Ruisë në Komisionin e Reformave, i përkrahur edhe nga ai i Italisë, ia doli të mënjanojë organizimin e sanxhakut shqiptar të Kosovës.<sup>1209</sup>

“Puqja” e parë ruso-italiane në Komision Ndërkombëtar si dhe mënjanimi i propozimit të Austro-Hungarisë bëri që ajo të kërkojë që nga reformat të përjashtoheshin jo vetëm Vilajeti i Shkodrës dhe ai i Janinës, por edhe tokat shqiptare të vilajetit të Kosovës e të Manastirit. Kjo sollti çrregullime të papritura midis fuqive të mëdha, por Vjena ishte e vendosur që të ndërpriste çfarëdo roli të Italianëve, që do t’ia rrezikonte konceptin e saj për ruajtjen e interesave në këtë pjesë.

Nën trysninë austro-hungareze Komisioni Ushtarak Ndërkombëtar, në shkurt të vitit 1904, vendosi të përjashtonte përkohësisht nga reformat krahinat perëndimore të vilajetit të Manastirit e të Kosovës, në të cilat Shqiptarët përbënin shumicën e popullsisë (bëhej fjalë për sanxhakun e Korçës - me përjashtim të kazasë së Kosturit, për sanxhakun e Elbasanit, për pjesën perëndimore të kazasë së Ohrit, për gjithë sanxhakun e Dibrës, për atë të Prizrenit, për pjesën jugore e perëndimore të

---

<sup>1207</sup> “*Diplomatische Aktenstücke*”, Wien, 1906, faqe 27.

<sup>1208</sup> Po aty.

<sup>1209</sup> Ruchti, Jacob: “*Die reformaktion Österreichs-Ungarns und Russlands in Mazedonien 1903-1908*”, Gotha, 1918, faqe 6.

sanxhakut të Pejës dhe për kazatë e Plevlës e të Senicës në sanxhakun e Pazarit të Ri).

Në përputhje me këtë ndarje, Komisioni Ushtarak, më 5 prill 1904, mori vendimin përfundimtar lidhur me ndarjen e zonave që u nënshtroheshin reformave. Austro-Hungaria e mori sanxhakun e Shkupit, Rusia sanxhakun e Selanikut, Anglia sanxhakun e Ohrit, Franca sanxhakun e Serezit, ndërsa Italia sanxhakun e Manastirit.<sup>1210</sup>

Gjenerali De Gjergjisi kërkonte që edhe rajoni i Prishtinës dhe i Prizrenit të hyjnë në kuadrin e reformave, por kjo u kundërshtua nga Austro-Hungaria, e cila nuk ishte e gatshme me asgjë t'u bënte lëshime italianëve në pjesët shqiptare. Gjenerali italian, këtë do ta arsyetojë me atë se në Myrsteg nuk ishte vendosur që prej planit të reformave të përjashtohet vilajeti i Kosovës, meqë këtë nuk do ta lejonte Rusia e cila kishte parasysh kërkesat e Serbisë që vilajeti i Kosovës me çdo kusht të përfshihej në këtë pako, sepse vetëm ashtu asaj ia "*mbronte karakterin serb*".<sup>1211</sup>

Madje, për zbatimin e reformave në Kosovës, ishte e interesuar edhe Perandoria Osmane. Gjatë gjithë kohës së propozimeve kërkonte që edhe ajo të përfshihej në to. Qeveria osmane kishte frike prej qëndrimit dhe pretendimeve austro-hungareze, prandaj u propozoi Fuqive të Mëdha që programi i reformave të zgjerohet edhe në krahinat shqiptare, ndërsa zbatimin e reformave ta mbikëqyrin shtetet e mëdha.<sup>1212</sup>

Shikuar nga interesi osman, kjo duket paksa paradoksale, kur dihej se pjesët që përfshiheshin në zonat e reformave, duke iu nënshtuar mbikëqyrjes ndërkom-bëtare, praktikisht humbin mbikëqyrjen e saj. Megjithatë, hesapi këtu kishte të bënte me frikën e Portës së Lartë se lënia jashtë reformave e pjesëve të vilajeteve shqiptare, mund të lidhej me pretendimet e Austro-Hungarisë, që në vazhdim e sipër, Shqipërinë ta shpallte vilajet autonom në mënyrë që shtrirja e saj të lidhej me Bosnjën dhe Hercegovinën për ta krijuar "rripin" e gjatë të zonës austro-hungareze nga Sarajeva, Shkodra, Prishtina, Shkupi e Manastiri deri në Janinë.

Konfigurimin e mbikëqyrjes së vilajeteve shqiptare (atyre të përfshira në reforma dhe atyre që nuk do të përfshihen në to, veçmas pjesës më të madhe të vilajetit të Kosovës) Vjena do ta arrijë dhe me sukses në saje të asaj se Rusia ishte e zënë në luftë me Japoninë. Rusia, madje, në një farë mënyre do t'i japë sqarime Serbisë, se edhe më tutje do të mbroheshin interesat e saj në Kosovë,<sup>1213</sup>ani pse dihej se në

---

<sup>1210</sup> "Diplomatische Aktenstücke", Wien, 1906, nr, 36.

<sup>1211</sup> "Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914", Përmbledhje e akteve diplomatike të Ministrisë së Jashtme të Gjermanisë, vëllimi, 22, nr. 7390.

<sup>1212</sup> M. B: "Stara Srbija i reforme", Beograd, 1906, faqe 7, sipas Pllana, Emin: "Kosova dhe reformat në Turqi", Prishtinë, 1978, faqe 195.

<sup>1213</sup> Čorović, Vladimir: "Odnosi Srbije i Austro-Ugarske u XX veku", Beograd, 1936, faqe 31.

ato rrethana ato ishin vetëm premtime të thata. Kjo nuk do ta pengojë Serbinë që vazhdimisht të protestojë për këtë dhe të kërkojë që Kosova të përfshihej në pakon e reformave dhe ato t'u besohen oficerëve italianë dhe francezë.<sup>1214</sup>

Lënia jashtë reformave të një pjese të mirë të sanxhaqeve shqiptare dhe mos-përfshirja në asnjërën prej zonave të Fuqive të Mëdha e sanxhakut të Prishtinës, një nga më të mëdhenjtë e vilajetit të Kosovës, ndonëse jo drejtpërdrejt, ishte pranim nga Fuqitë e Mëdha i karakterit etnik shqiptar të të gjitha këtyre territoreve, (domethënë të vilajetit të Kosovës dhe të krahinave perëndimore të vilajetit të Manastirit), që shënoi njëherazi një fitore të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, kjo nuk ua hoqi atyre rrezikun që u kanosej nga pretendimet serbe, bullgare dhe greke me të cilin ballafaqoheshin në vazhdimësi.

Përkundrazi, Beogradi, Sofja dhe Athina, të mbështetura dhe të drejtuara nga Rusia, do të bëjnë çmos që te kjo pikë të fokusojë veprimi i tyre i mëtutjeshëm në mënyrë që të pengojë, që Kosova të kthehej në një bastion të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, siç kishte ndodhur gjatë “Lidhjes Shqiptare e Prizrenit”, kur atje do të promovohet jo vetëm lufta për mbrojtjen e tokave shqiptare, por edhe shfaqja e bërthamës së shtetësisë shqiptare, siç do të ndodhë në vitin 1880 me formimin e Qeverisë së Përkohshme që do të dalë nga Kuvendi i jashtëzakonshëm i “Lidhjes Shqiptare”, të mbajtur në Prizren pas rënies së Ulqinit, që do të shfaqet pas katër shekujsh e diç më shumë të pushtimit osman për t'u ndërlidhur me veprën e Gjon Kastriotit Skënderbeut.

## KAPITULLI I SHTATË

### XHONTURQIT DHE SHQIPTARËT

#### OPSIONI I RRËZIMIT TË DESPOTIZMIT ME ANËN E REVOLUCIONIT

Marrëveshja e Myrstequt, krahas ripohimit të ekuilibrit të forcave që pak a shumë ekzistonte midis Austro-Hungarisë dhe Rusisë në Ballkan dhe, ky qe funk-

---

<sup>1214</sup> Po aty, faqe 36



sioni kryesor i saj, pati edhe dy rrjedhoja anësore, rëndësia e të cilave do të bëhej më e qartë disa vjet më vonë.<sup>1215</sup> Sepse, nëse për Fuqitë e Mëdha, Myrstegu ishte veçse një ushtrim praktik për administrimin e krizës, Greqia, Serbia dhe Bullgaria zunë ta interpretonin ndryshe marrëveshjen e arritur aty, kryesisht në përputhje me synimet e tyre hegjemoniste kahmot të shpallura në programet nacionale siç ishte “*Naçertanaja*” serbe, “*Megaliidhea*” greke, të cilave tashmë u bashkëngjitej edhe ideja e Sofjes për Bullgarinë e madhe dhe, këtë ta bëjnë madje, në përputhje me një klauzolë të saj (*pika C*), me të cilën lejohej rishikimi i kufijve administrativë, si thuhej në të: “*me synimin për të krijuar grupe më të qëndrueshme kombësish të ndryshme*”.<sup>1216</sup>

Kjo klauzolë, e cila nuk ishte pa nxitjen e hileve, nga këto shtete u kuptua si provë gjeopolitike për copëtimin përfundimtar të vilajeteve shqiptare (Kosovës dhe të Manastirit), të ngritur si Maqedoni midis tyre. Përrjashtimi i pjesës më të madhe të Kosovës nga programi i reformave (tri sanxhaqe jugore), meqë ishin të banuara kryesisht me Shqiptarë dhe kjo do të thoshte njohje ndërkombëtare e karakterit të tyre etnik shqiptar, hasi në rezistencë të shteteve të ballkanike, të cilat nisën të botojnë statistika dhe shënime të ndryshme për gjendjen numerike të popullsisë, ku ajo pasqyrohej ndryshe nga ç’ ishte, pra me pretendimet që të tregojë “e përzier”, me shumicë serbe ose greke, me ç’rast silleshin dëshmi të kurdisura dhe “tapi” mesjetare që mbështeteshin në regjistra të inkriminuar dhe të manipuluar të kishave dhe monumenteve të tjera të kulteve kishtarë të krishtera, të cilat njësoj u takonin edhe Shqiptarëve.<sup>1217</sup>

Këto shënime dhe këto “dëshmi” që u dërgoheshin Fuqive të Mëdha kishin për qëllim që edhe Vilajeti i Kosovës dhe pjesët e tjera të Vilajetit të Manastirit të përjashtuara nga programi i reformave në saje të strukturës etnike shqiptare, të futeshin në programin e reformave, në mënyrë që kështu atyre t’u mohohet karakteri etnik shqiptar. Por, Austro-Hungaria, e cila ishte ideatore e gjithë programit të reformave dhe kishte fjalën kryesore gjatë përcaktimit të pjesëve që duhej të përfshiheshin në to, përpiquej që ato të mos zgjeroheshin në pjesën qendrore të vilajetit të Kosovës dhe atë të Shkodrës. Me anën e statistikave të ndryshme dhe me

---

<sup>1215</sup> Glenny, Misha: “*Historia e Ballkanit 1804-1999*”, Tiranë, 2007, faqe 208.

<sup>1216</sup> Po aty, faqe 208.

<sup>1217</sup> Më gjerësisht rreth manipulimit me regjistrat dhe krijimin e statistikave të rreme shih në “*Kosova*”, libri i parë (Antika dhe Mesjeta), Prishtinë, 2012 në kapitullin: “*Arbrit dhe raportet etnike me pushtuesit sllavë në shekujt XIII-XIV*”, faqe 461-481.

propagandën diplomatike dhe atë që do ta vendosë në mediat e veta, Vjena vërtetonte se shumicën e popullsisë në këto vende e përbënin Shqiptarët.<sup>1218</sup>

Madje, duke shfrytëzuar gjendjen ndërkombëtare, sidomos pozitën e vështirë të Rusisë nga lufta me Japoninë, Austro-Hungaria arriti të fitojë të drejtën e zbatimit të reformave në pjesën më të madhe të hapësirës ku bënin pjesë tokat prej Pazarit të Ri dhe kufiri shqiptar të veriut deri në Kriva Pallanka dhe Kratova.<sup>1219</sup>

Kështu, nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejt të oficerëve austro-hungarezë ishte sanxhaku i Shkupit që e ndante Serbinë prej asaj që projektohej si Maqedoni bashkë me kazanë e Kaçanikut, me shumicë shqiptare. Kjo hapësirë e rëndësishme strategjike, asaj i mundësonte depërtim në lindje.

Meqë Bullgaria tashmë kishte pësuar një disfatë të rëndë pas shuarjes së Kryengritjes së “Ilindenit” dhe nga Perandoria Osmane i kanosej ndëshkimi i drejtpërdrejtë po që se, si më parë, do të vazhdonte t’i dërgonte çetat bullgare në pjesën e vilajeteve të Kosovës dhe të Manastirit që prej saj shihej si Maqedoni, ose në çfarëdo forme do të përkrahte VMRO-në këtë pjesë, mbeteshin Serbia dhe Greqia, të cilat do të hynin në këtë garë. Secila me pretendimet e veta, ku si “atu kryesore të pranisë së tyre etnike” shfaqeshin bandat e tyre, qoftë të organizuara nëpër vendbanimet serbe dhe greke, qoftë ato që kohë pas kohe futeshin nga jashtë, pra nga Serbia dhe Greqia, të cilat kishin për qëllim që me anën e vrasjeve, zullumeve të ndryshme, të përkeqësonin gjendjen në pjesët me shumicë shqiptare.

Ky përkeqësim ishte i një natyre strategjike, sepse bandat serbe dhe ato greke, veçmas këto të parat, duhej të operonin nëpër pjesët ku propaganda hegjemoniste e Beogradit po edhe ajo e Athinës, kishin filluar që Komisionit Ndërkombëtar dhe qeverive të Fuqive të Mëdha të angazhuara në atë që projektohej Maqedoni, t’i dërgonin “tapi” të rreme të fabrikuara prej kohësh, të cilat shfaqeshin si “mbetje mesjetare serbe”, që edhe “si të rrudhura nga dhuna shekullore e arnautëve” shprehnin “karakterin mesjetar serb të Kosovës”, “karakter ky” që edhe më tutje rrezikohej nga zullumet arnautë, ndaj të cilave Serbët apo edhe Grekët vendorë, të lënë në mëshirën e pamëshirë të zullumqarëve, duhej të vetëmbroheshin me anën e “rojeve” të katundeve apo të manastireve!<sup>1220</sup>

---

<sup>1218</sup> Pllana, Emin: “Kosova dhe reformat në Turqi”, Prishtinë, 1978, faqe 198.

<sup>1219</sup> Po aty, faqe 199.

<sup>1220</sup> Më gjerësisht rreth veprimtarisë diversive të Beogradit në organizimin e çetave - çetnikëve në Kosovë si dhe veprimtarinë e tyre e cila dirigohej nga një qendër e përgatitur mirë për veprime të tilla, ku enklavat serbe dhe manastiret ortodokse, të shpallura serbe, duhej të instrumentalizoheshin shih: dhe Hadži-Vasiljev, Jovan: “Četnička akcija u Staroj Srbiji i Makedoniji”, Beograd, 1928 dhe Branko Perunović: “Pisma srpskih konzula iz Prištine 1890-1900”, 1985.

Në të vërtetë, ato nuk ishin çeta mbrojtëse të njerëzve të dëshpëruar skajshmërisht, siç thuhej, të cilëve nuk u kishte mbetur tjetër pos armës, por ishin çeta të organizuara nga Beogradi me oficerë dhe ushtarakë të futur në to, të cilët vepronin në ato pjesë për këto qëllime, në mënyrë që edhe ato të përfshiheshin në rrethin e reformave dhe kështu t'u merrej tretmani i etnisë shqiptare.<sup>1221</sup>

Madje, këto çeta dhe banda, tashmë kishin filluar të vepronin edhe në pjesët ku nuk kishte fare Serbë me qëllim që Shqiptarët të provokoheshin edhe më tutje dhe të kundërpërgjigjeshin me hakmarrje në pjesët ku banonin Serbët dhe kështu t'u ngarkoheshin veprimet kundër tyre. Për këto qëllime nuk do të mungojnë as vetëdëmtimet dhe përdhosjet që u bëheshin disa kishave ortodokse, të cilat pastaj alarmoheshin si vepër e Shqiptarëve, edhe pse fare mirë dihej se manastiret dhe kishat mesjetare ortodokse në Kosovës ishin kulte fetare që njësoj u takonin edhe Shqiptarëve (pjesa më e madhe e tyre para ardhjes së osmanëve, si të krishterë, i takonin ritit ortodoks), që si të tilla ishte e natyrshme t'i ruanin edhe në kohët kur në shumë pjesë të Kosovës nuk ka pasur fare serbë ose që kishin qenë në pakicë. Manastiret ortodokse dhe kultet e tjera fetare nga Shqiptarët do të ruhen edhe kur Patrikana ortodokse serbe do të largohet nga Kosova në shekullin XVII. Do të jenë vojvodët shqiptarë të kishave dhe të manastireve (në Deçan, Pejë, Deviq dhe të tjera), që do t'i ruajnë ato me çmimin e sakrificave madje pse i ndjenin si kulte të traditës së tyre shpirtërore shumëshekullore.<sup>1222</sup>

Trysnia e vazhdueshme dhe hesapi i destabilizimit të vilajeteve shqiptare megjithatë kërkonte pjesëmarrje të përbashkët të të gjithë pretendentëve për tokat shqiptare. Kjo bëri që Serbia, ndonëse kishte interesa që Bullgaria të mbahej sa më anash vilajetit të Kosovës dhe atij të Manastirit, serish t'i kthehej lidhjeve me të, në mënyrë që duke e afruar kështu te kullaçi ballkanik ta largonte prej ndonjë aleance të mundshme me Shqiptarët, e cila do të mund të nxitej nga Austro-Hungaria, që dyshohej se mund të luante edhe në këtë kartë meqë diçka të tillë parapëlqenin edhe gjermanët, të cilët Bullgarinë e shihnin si një hapësirë që ishte në përputhje me interesat e tyre. Pas disa bisedimeve të ndërsjella, më 30 mars 1904, u lidh traktati midis Beogradit dhe Sofjes, i cili ndonëse për moto kishte “përkrahjen e

---

<sup>1221</sup> Po aty.

<sup>1222</sup> Shih: Krasniqi, Mark: “*Manastirske vojvode u Kosovsko-Metohijskoj oblasti*”, Glasnik KM, III, Prishtinë, 1958; Rizaj, Skënder: “*Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*”, Prishtinë, 1982; Gjini, Gaspër: “*Raško Prizrenska Biskupija*”, Zagreb, 1968; Marquet, Odette: “*Pjetër Bogdani – letra dhe dokumente*”, Shkodër, 1997; Malcom, Nole: “*Kosova një histori e shkurtër*”, Prishtinë, 2001.

aksionit të reformave”, në të vërtetë kërkonte bashkëveprimin e dy shteteve që të ndikonin që reformat të zgjeroheshin edhe në Vilajetin e Kosovës.<sup>1223</sup>

Kjo marrëveshje, pas një muaji, do të përcillet me një traktat tjetër të Serbisë dhe Bullgarisë me ç’rast këto dy vende u morën vesh rreth asaj që vilajeti i Kosovës t’i takojë Beogradit, si kompensim për atë që Bullgaria kishte marrë në Rumenlinë Lindorë.<sup>1224</sup>

Paraprakisht, një marrëveshje për copëtimin e tokave shqiptare, Beogradi do të lidhë edhe me Cetinën, më 2 shkurt 1904. Marrëveshja parashihte ndarjen e sferave të interesit midis dy vendeve. Kështu, Serbisë duhej t’i takonte Vilajeti i Kosovës, sanxhaku i Pazarit të Ri dhe një pjesë e Vilajetit të Manastirit.<sup>1225</sup>

Që ky zhvillim të pengohej të mos kthehej në pakt të hapur kundër reformave, pra karshi aleancave të ndërsjella të tri vendeve ballkanike, dy prej të cilave (Serbia dhe Bullgaria) mbikëqyreshin nga Rusia, Austro-Hungaria detyroi Rusinë që bashkërisht t’u dërgojnë notë qeverive të Beogradit, të Sofjes dhe të Athinës, ku u kërkohej ta ndërpresin veprimtarinë e çetave të tyre në vilajetet reformuese, sepse ashtu rrezikohej thyerja e *status quo-s*, e cila u duhej Fuqive të Mëdha edhe më tutje.<sup>1226</sup>

Në përgjigjen e vet, Beogradi u deklarua se do të punonte për zbatimin e reformave, por prapë përsëriti kërkesën që edhe Vilajeti i Kosovës (pjesët e papërfshira në pakon e reformave) të përfshiheshin në to. Serbia bëri të ditur se “*çetat nuk i kishin krijuar shtetet fqinje, por dhuna e Shqiptarëve ndaj Serbëve dhe të krishterëve atje, si vetëmbrojtje*”, gjë kjo duhej pasur parasysh po qe se kërkohet rend dhe qetësi në atë pjesë.<sup>1227</sup>

Porta e Lartë caktoi një komision të drejtuar prej Ali Riza Pashës për riorganizimin e xhandarmerisë në Vilajetin e Kosovës. Sipas planit të Hilmi Pashës ajo duhet të ketë 2800 veta, prej të cilëve 2% do të jenë të krishterë, numri i nëpunësve të policisë do të jetë 202, ndërkohë që do të fillojë edhe fushatën për vjeljen e tatimeve dhe të çarmatosjes së popullatës.<sup>1228</sup>

---

<sup>1223</sup> Čorović, Vladimir: “*Borba za nezavisnost Balkana*”, Beograd, faqe 126.

<sup>1224</sup> Aleksić P, Liljana: “*O srpsko-Crnogorskim pregovorima o savezu 1904-1905*”, Istorija XX veka “*Zbornik radova*”, I, Beograd, 1959, faqe 338, cituar sipas Pllana, Emin: “*Kosova dhe reformat në Turqi*”, Prishtinë, 1978, faqe 199.

<sup>1225</sup> Po aty, faqe 199.

<sup>1226</sup> Jovanović, Jovan M: “*Borba za narodno ujedinjenje 1903-1908*”, Beograd, 1938, faqe 147.

<sup>1227</sup> Po aty, faqe 148.

<sup>1228</sup> Pllana, Emin: “*Kosova dhe reformat në Turqi*”, Prishtinë, 1978, faqe 200.

Mospërfshirja e vilajetit të Kosovës në reforma, përkundër njohjes së parë jo-formale të identitetit etnik shqiptar nga Fuqitë e Mëdha, nuk do ta kursehet edhe nga vështirësitë e dyanshme: ato që i vinin nga bandat serbe, greke dhe bullgare, që tashmë kishin filluar të përhapeshin në shumë pjesë të saj, si dhe nga përpjekjet e Portë së Lartë që t'i zbatonte reformat që ishin marrë përsipër nga Fuqitë e Mëdha, e të cilat kryesisht u referoheshin atyre që Sulltan Hamiti një vit më parë i kishte shpallur me rastin e dekretit të tij për krijimin e “megavilajetit” të Rumelisë.

Këto masa, veçmas çarmatosja nga Shqiptarët u pritën me protesta, po edhe me rezistencë të armatosur. Ajo nisi të shfaqet në shumë pjesë të Kosovës. Vërehet se në Pejë, forca të caktuara kryengritëse do të sulmojnë burgun e qytetit dhe do të kërkojnë largimin e mytesarifit të Pejës. Në Vuçitërnë do të vritet kajmekami dhe do të përzihen nëpunësit e shtetit. Veprime të ngjashme do të ketë edhe në pjesët tjera.<sup>1229</sup>

Porta e Lartë u kundërpërgjigj me një fushatë të armatosur të drejtuar nga Omer Pasha, i cili me 9 batalione sulmoi Prizrenin dhe pjesët tjera të Dukagjinit, me ç'rast zuri më se 25 krerë që drejtonin rebelimet dhe i mërgoi në Anadoll.<sup>1230</sup> Për në Anadoll do të internohen edhe 150 kryengritës nga Peja dhe 153 nga Gjakova dhe rrethina.<sup>1231</sup>

Në pjesët e Vilajetit të Kosovës të mbetura jashtë reformave, ku pushteti osman kishte mbikëqyrjen dhe zotohej për zbatimin e reformave, gjendja filloi të përkeqësohej edhe nga ndërhyrjet e konsujve serbë, të cilët tashmë ishin në Prishtinë dhe në bashkëveprim me konsujt rusë, vepronin haptas që ta organizonin popullatën serbe të Kosovës, e cila ndonëse ishte në pakicës dhe e privilegjuar, me sugjerimet serbo-ruse, krijoi një *Këshill Kombëtar*, i cili krahas refuzimit të tatimeve, filloi të shtronte kërkesën për “çetat vetëmbrojtëse” me arsyetimin se këtë, duhej ta bënin ata, kur nuk mund ta bënte pushteti osman.<sup>1232</sup>

Në kazatë e Sjenicës dhe të Pazarit të Ri popullsia sllave refuzoi të paguajë tatimin dhe vazhdoi veprimtarinë e çetave serbe në këto anë. Për këtë veprimtari Austro-Hungaria akuzoi drejtpërsëdrejti konsullin rus në Shkup, Orlov dhe konsujt serb në Prishtinë për të cilët thuhej se nuk kujdeseshin për rajonin e vet, por

---

<sup>1229</sup> Po aty, faqe 201.

<sup>1230</sup> Kaleshi, Hasan/Jürgen, Hans: “*Vilajeti i Prizrenit*”, “*Përparim*”, Prishtinë, 1967, nr. 2-3, faqe 187 dhe Pllana, Emin: “*Kosova dhe reformat në Turqi*”, Prishtinë, 1978, faqe 2001.

<sup>1231</sup> Pllana, Emin: “*Kosova dhe reformat në Turqi*”, Prishtinë, 1978, faqe 201.

<sup>1232</sup> Perunović, Branko “*Pisma srpskih konsula iz Prištine*”, Beograd, 1985.

më tepër për atë të Pejës dhe të Sjenicës, ku trimëronin popullatën serbe që t'u bashkohej çetave kryengritëse.<sup>1233</sup>

Me vështirësi të shumta gjendja shfaqej edhe në zonat e reformave që i mbikëqyrte Austro-Hungaria (sanxhaku i Shkupit). Në nëntë kazatë e Vilajetit të Kosovës, që hynë në zonat reformuese, organizimi i xhandarmerisë nuk shkonte sipas parashikimeve, sepse popullata shqiptare kishte bindjen se masat e reja nuk kishin për qëllim përmirësimin e gjendjes për të gjithë, pos për të krishterët. Këta fitonin privilegje të mëdha në dëm të tyre dhe kështu përgatitej terreni për copëtimin e vendit. Kjo arsyetohej me lirimin e të krishterëve nga tatimi për një vit si dhe me aksionin e çarmatimit të popullatës, të cilit i nënshtroheshin Shqiptarët, ndërsa Serbët përjashtoheshin prej tij, madje edhe atëherë kur ata u bashkoheshin çetave serbe dhe bullgare që vepronin në rrethinën e Karadakut të Shkupit si dhe në Luginën e Preshevës.

Megjithatë, telashe të reja, si për Shqiptarët, po edhe për vetë Fuqitë e Mëdha të angazhuara për zbatimin e reformave në pjesët e përfshira sipas marrëveshjeve të Myrstequt, paraqitnin raportet me Perandorinë Osmane, e cila, pos me anën e fushatave ushtarake duhej të vringëllonte armët kundër Shqiptarëve – dhe këtë e bënte në mënyrën e vet të shumtën duke i kthyer ata kundër vetes, nuk ishte e interesuar për zbatimin e pakos ekonomike dhe asaj gjyqësore në përputhje me zotimet e marra.

Ç'është e vërteta, pakoja ekonomike, e paraparë me marrëveshje, shfaqej e pa definuar sa duhej dhe kornizat nuk i mjaftonin krijimit të një gjendjeje të re, ku sistemi tatimor do të ishte në shërbim të reformave të gjithëmbarshme. Kjo nuk do të thoshte që çështjet të mos sqaroheshin dhe të viheshin në binarë të një ndryshimi rrënjësor që do të ishte i dobishëm në radhë të parë për popullatën vendore, që ashtu të fitonte besimin në to. Kjo ishte një parakusht për çfarëdo suksesi. Fuqitë e Mëdha, edhe pse kishin interesat e tyre strategjike në këtë hapësirë dhe vepronin në përputhje me to, e dinin se ishin ndryshimet në planin ekonomik që mund të përmirësonin gjendjen. Ashtu do të fitohej besimi nga popullsia vendase, dhe se ato pa bashkëpunimin e sinqertë dhe të vendosur të Perandorisë Osmane nuk ishin të mundshme.

Në janar të vitit 1905 ambasadorët e Austro-Hungarisë dhe të Ruisë në Stamboll e përpiluan projektin e reformave financiare për tri vilajetet të cilat duhej të zbatoheshin në pajtim me Portën e Lartë dhe Bankën Osmane.<sup>1234</sup>

---

<sup>1233</sup> Pllana, Emin: "Kosova dhe reformat në Turqi", Prishtinë, 1978, faqe 206.

Sipas projektit, çdo sanxhak dhe kaza duhej ta kishte buxhetin e vet; të ardhurat nga tri vilajetet dhe Dogana e Selanikut të mbështeteshin në filialin e Bankës Osmane në Selanik, Manastir dhe në Shkup. Të gjitha të ardhurat dhe të dalat të kryheshin nëpërmjet kësaj banke: për t'i paguar nëpunësit, ushtrinë, xhandarmerinë, oficerët e reformës, etj. Buxhetin e vilajeteve duhej ta kontrollonin inspektori gjeneral dhe agjentët civilë. Porta e Lartë e pranoi projektin austro-rus të reformave financiare por me kusht që fuqitë e mëdha të pranojnë rritjen e doganës të importimit prej 8% në 11%, të cilat në fillim nuk i pranuan.<sup>1235</sup> Më vonë do të pranohen pas disa kundërshtimeve dhe mosmarrëveshjeve të cilat nuk ishin vetëm të natyrës parimore, po edhe të asaj strategjike. Sepse, Anglia ishte e interesuar që reformat ekonomike mos të mbeteshin vetëm në duart e Vjenës dhe Petërbergut, por të ishin nën një mbikëqyrje më të madhe ndërkombëtare, ku do të merrnin pjesë përfaqësuesit e gjashtë Fuqive të Mëdha. Kjo trimëronte Portën e Lartë që të ruante autoritetin e vet sa më shumë që të ishte e mundur në këto çështje.<sup>1236</sup>

Qëndrimin të Anglisë, në njëfarë mënyre, do t'i bashkohet edhe Italia, e cila po ashtu nuk ishte e interesuar për rol dominues të Austro-Hungarisë edhe në këtë fushë, meqë frikësohej nga projekti i Vjenës për përfshirjen e plotë të Shqipërisë nën zonën e ndikimit të saj. Me këtë Romës i pamundësohej depërtimi në Ballkan në përputhje me synimet e saj, që si do të shihet, do të jenë shumë të drejtpërdrejta veçmas ndaj hapësirës shqiptare pa përjashtuar këtu edhe përpjekjet për aleanca me fqinjët e Shqiptarëve ndaj të cilëve ajo duhej të kishte qëndrim në përputhje me atë të arritur në kuadër të Lidhjes Trepalëshe. Edhe këtu Roma do t'i bashkohet kompromisit që do të arrihet me formimin e një Komisioni Financiar Ndërkombëtar me agjentë civilë dhe me anëtarë të Fuqive të Mëdha.

Në mars të vitit 1905 u formulua rregullorja e detyrave të këtij komisioni që duhej të funksiononte dy vjet me qendër në Selanik. Komisioni ndërkombëtar kishte gjashtë anëtarë: baroni i Gjermanisë – J.P. Grizinger, përfaqësuesi i Francës – L. Steeg, i Italisë – F. Maissa, i Anglisë – Harvej, i Austro-Hungarisë – Openheimer, i Rosisë – N. Demernik dhe i Turqisë – Xhemajl bej.

Komisioni do të përcillte gjithë gjendjen në vilajete, kontrollin në mbledhjen e tatimeve, nëpunësit dhe shërbimet e tjera. Rregullorja financiare kishte 15 pika ndër të cilat më të rëndësishmet ishin ato me të cilat Porta e Lartë zotohej për

---

<sup>1234</sup> Попов, Радослав: “Аустро-унгарија и реформат в Европска турција 1903-1908”, Софија, 1974 (Popov, Radoslav: “Austro-Ungarija i reformite v Evropskejska Turcija 1903-1908”, Sofja, 1974), faqe. 110 dhe Pllana, Emin: “Kosova dhe reformat në Turqi”, Prishtinë, 1978, faqe 211.

<sup>1235</sup> Pllana, Emin: “Kosova dhe reformat në Turqi”, Prishtinë, 1978, faqe 211.

<sup>1236</sup> Po aty.

zbatimin e ligjit të ri për minierat, atë për dogana si dhe shpërndarjen e të ardhurave në vilajetet e Rumelisë, të cilat fitonin më shumë të ardhura dhe mundësi për zhvillim. Fuqitë e Mëdha me këtë rast pranuan kushtin kryesor të Portës së Lartë për rritjen e doganës në import nga 8 në 11%.

Por, ajo që përbënte “unitetin” e Fuqive të Mëdha për reformat financiare dhe për ato juridike, të cilat do të mbetën në gjysmë të rrugës, ku prapë do të mbizotërojnë qëndrimi i Austro-Hungarisë dhe i Gjermanisë, do të përcaktohet nga gatishmëria e Portës së Lartë që të jepte dy koncesione të rëndësishme: njërit për ndërtimin e hekurudhës së Pazarit të Ri (nëpërmes Mitrovicës do të lidhte Bosnjën dhe Hercegovinën me Kosovën dhe Selanikun), dhe tjetrit, të hekurudhës së Bagdadit. Vjena ia doli që të fitojë koncesionin e hekurudhës Pazar i Ri – Kosovë nëpër Maqedoni për në Selanik, ndërsa Berlini fitoi koncesionin e hekurudhës së Bagdadit.<sup>1237</sup>

Këto dy koncesione do të kenë ndikime të dyanshme: midis Fuqive të Mëdha dhe, midis vendeve ballkanike dhe do t’ia hapin udhën ndarjes së sferave të interesit si dhe ashpërsimit të tyre, që për pasojë do të kenë Luftërat Ballkanike dhe Luftën e Partë Botërore. Italia do të jetë e pakënaqur me hekurudhën ballkanike, meqë Austro-Hungaria, nëpërmes vilajeteve shqiptare, lidhte Bosnjën dhe Hercegovinën me Selanikun, kështu që dilte në Egje. Ndërsa Anglia do të jetë e pakënaqura me hekurudhën e Bagdadit, ku Gjermanët fitonin mjetin kryesor për të mbikëqyrur resurset e mëdha energjetike të Lindjes së Mesme dhe për ta forcuar pozitën e tyre atje.

Ishte ky një shkas i mirë për Anglezët për t’u liruar nga “harmonia” e Fuqive të Mëdha rreth ruajtjes me çdo kusht të *status quo-s* dhe, mbase do ta bënte, po mos të ishte pozita e dobësuar e Ruisë pas luftë së humbu me Japoninë, e cila kishte rënë plotësisht nën ndikimin e Austro-Hungarisë dhe veçmas të Gjermanisë. Ndërkohë edhe Portës së Lartë dobësimi i Ruisë dhe pamundësia e Anglisë që të veprojë kryenvete, ia kishte shtuar edhe më shumë përkushtimin që të mbështetej te lidhjet me Austro-Hungarinë dhe veçmas ato me Gjermaninë, meqë kapitali i këtyre vendeve siguronte mundësi për ta kthyer fuqinë e humbur, duke bërë modernizimin e vendit në përputhje me konceptet zhvillimore gjermane që ishin ndër më dinamikët në Perëndim.

Madje, këtu del në pah edhe sjellja absurde e Sulltan Hamitit, i cili në një rën anë kërkonte forcimin e kalifatit me anën e frymës islamiste duke vazhduar qeverisjen despotike, në tjetrën anë, ai do të bëjë përpjekjet të mëdha që ta modernizojë ekonomikisht dhe financiarisht Perandorinë Osmane sipas modelit gjerman,

---

<sup>1237</sup>Popov, Radoslav: “Austro-Ungarija i reformite v Evropskejska Turcija 1903-1908”, Sofja, 1974, faqe. 110.



gjë që nxirrte në pah një përpjekjet për shtet të organizuar perëndimor që do të qeverisej me despotizëm lindor.

Në këtë frymë do të lejojë linjat e reja hekurudhore që lidhin Ballkanin me Perëndimin (hekurudha Bosnje-Kosovë-Selanik) si dhe atë të orientit deri në Bagdad. Gjatë pesë viteve të fundit Sulltan Hamidi kishte pasur dy takime miqësore me kaiserin gjerman Villhelm II, me ç'rast do të lidhë disa marrëveshje afatgjate tregtare dhe ekonomike, me të cilat do t'u hapet rruga investimeve ekonomike gjermane në Lindje, sidomos kapitalit të Gjermanisë. Nëse kësaj i shtohen edhe marrëveshjet rreth modernizimit të armatës osmane (në planin e teknologjisë ushtarake dhe të organizimit të saj) prej më shumë se katër vitesh, që kishte marrë përsipër Gjermania, koncesionet e hekurudhës së Bagdadit, atë e kthenin në aleat kryesor të Perandorisë Osmane që mbështetej mbi bazën e modernizimit të vendit.

Koncesionet hekurudhore që Perandoria Osmane do t'ua japë Vjenës dhe Berlinit, me shqetësim të madh do t'i presin edhe vendet ballkanike, veçmas Serbia. Beogradi do të bëjë deponime të njëpasnjëshme te Rusia, e më vonë edhe te Italia, që Austro-Hungaria të mos lidhë vijën hekurudhore Sarajevë – Pazar i Ri – Kosovë – Shkup dhe Selanik, meqë sipas saj, ajo çrregullonte balancat rajonale dhe më gjerë, ndërkohë që ndihmonte *“okupimin paqësor të Kosovës”* dhe *“lidhjen e saj tokësore me Bosnjën dhe Hercegovinën dhe me të edhe me Europën gjermane”*.<sup>1238</sup>

Është me interes të thuhet se përkrahës dhe madje aleatë kryesorë kundër projektit të hekurudhave austro-hungareze që do të lidhnin Kosovën me Bosnjën dhe Hercegovinën dhe me këtë edhe me Europën, Serbia do të ketë një pjesë të madhe të feudalëve nga radhët e parisë shqiptare të Kosovës. Ata do të kthehen në pengues dhe frenues kryesor këtij projekti dhe do ta sjellin para dështimit.

Ky dështim, si do të shihet pak më vonë, Shqiptarëve do t'u kushtojë më së shumti. Sepse, ishte fare e natyrshme se me lidhjen hekurudhore Pazar i Ri – Mitrovicë – Prishtinë – Shkup dhe Selanik, Austro-Hungaria nuk do ta lejonte okupimin e Kosovës në vitin 1912 nga Serbia. Dhe, as që do të pajtohej me mbetjen e saj nën Serbi në Konferencën e Ambasadorëve në Londër në vitin 1913. Meqë ashtu mbronte interesat e saj strategjike, të cilat lidheshin me jetësimin e kësaj hekurudhe.

Pra, në kohën kur Beogradi do të bëjë çmos që ta pengojë këtë projekt dhe do ta shpallë si *“komplot austro-gjerman kundër interesave strategjike serbe”*,<sup>1239</sup> në Kosovë, të nisura nga feudalë vendorë nga radhët e parisë së vendit dhe të klerit

---

<sup>1238</sup> Jovanović, Jovan M: *“Borba za narodna ujedinjanja 1903-1908”*, Beograd, 1938, faqe 148.

<sup>1239</sup> Po aty, faqe 149.

islamist, do të organizohen protesta dhe kryengritje të Shqiptarëve kundër hekurudhës europiane. Forca të mëdha kryengritësisë do të nisen nga Mitrovica për në Prishtinë dhe tutje, me moton që të ndalet hekurudha e veriut.

Feudalët shqiptarë bashkë me të tjerë kundërshtonin hekurudhën me arsyetimin se ajo sillte “*rrënimin e brendshëm të Perandorisë nga ana e gjermanëve*” e me këtë edhe të interesave të Shqiptarëve, ndërkohë që Porta e Lartë dhe vetë Sulltan Hamiti këtë e shihte si mundësi për zhvillimin edhe më të madh të vilajeteve europiane si dhe lidhjen e tyre më të mirë edhe me Perandorinë Osmane, meqë hekurudha nëpër Ballkan, mundësonte qarkullimin më të shpejtë të mallrave në të dy drejtimet.<sup>1240</sup>

Kundërshtimi që Shqiptarët do t’ia bëjnë hekurudhës europiane bashkë me refuzimin e zbatimit të reformave financiare dhe të atyre juridike, do t’i kthejë edhe më shumë në fokus të Italisë dhe të interesave të saj, që përputheshin edhe me ato serbe dhe greke, e që përkraheshin edhe nga francezët dhe britanikët, të cilët kërkonin që të pengonin afrinë e madhe austro-gjermane me Osmanët, e cila kishte edhe miratimin rus. Kjo njëherësh do të hapë edhe të çarat e mëtutjeshme midis vetë Shqiptarëve, ku feudalët dhe klerit fanatik islamist nga radhët e parisë së vendit gjenin gjithnjë e më shumë mbështetje nga italianët, siç mbështeteshin edhe nga Serbët dhe Grekët. Ndërsa, reformatorët (kryesisht intelektualët dhe përfaqësues të borgjezisë së re), do të mbështeten nga Austro-Hungaria dhe Gjermania, paçka se nuk e kishin lehtë bashkëpunonin me Vjenën dhe Berlini, ngaqë, në sajë të propagandës sllavo-ortodokse rreth Bosnjës dhe Hercegovinës, gjithnjë e më shumë anatemohehin nga paria dhe rryma e feudalëve dhe e klerit islamist “si gllabërues të Perandorisë Osmane”.

Do të shihet se gjithë ato zhvillime që do të shfaqen nga Marrëveshja e Myrsetegut e deri te Revolucioni Xhonturk i vitit 1908 dhe u përcaktuan si nga nevojat e brendshme ashtu edhe nga rrethanat e jashtme, ndikuan edhe në pozicionimin e mëtutjeshëm të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, që t’u nënshtrohet atyre. Kështu që bie në sy se kërkesa për barazi brenda Perandorisë Osmane, me krijimin e autonomisë shqiptare si bërthamë e shtetit autonom shqiptar, kërkesë kjo që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit kthehet në program politik dhe do të jetë gjithpopullore, filloi të dalë në plan të dytë, ose të zëvendësohet fare nga ajo “për çlirim kombëtar”, më shumë si parullë se sa fryt i një platforme që do të mbështetej në programe të caktuara që do të kishin pajtim kombëtar. Do të jetë një brez i tërë atdhetarësh me

---

<sup>1240</sup> Më gjerësisht rreth protestave dhe kryengritjeve të Shqiptarëve kundër ndërtimit të hekurudhës së veriut shih: HHStA, PA XII/ 312, Kral, Manastir, 3/2/1899 dhe “*Historia e popullit shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 312-316.

pikëpamje radikale, kryesisht nga radhët e shtresës së mesme (mësues të shkollave turke, nëpunës të aparatit shtetëror, gazetarë dhe intelektualë të rinj), po ku nuk mungonin edhe ushtarakët e pakënaqur me shfaqjen e çetave serbe, greke dhe atyre bullgare që kishin filluar ta fusnin vendin në një kaos dhe gjakderdhje të pandalshme kryesisht shkonte në dëm të popullatës myslimane, që morën nismën për krijimin e një organizate të fshehtë, e cila merrte përsipër edhe luftën e armatosur me anën e çetave dhe të komitëve.<sup>1241</sup>

Shikuar nga këndvështrimi i ngjarjeve dhe i zhvillimeve që tashmë përcaktoun aktualitetin shoqëror dhe atë politik të vilajeteve që ndërthureshin me çështjen e Maqedonisë, ku përqendrimi i Fuqive të Mëdha, po edhe ai i Perandorisë Osmane, kishte fokusuar përkujdesjen për popujt e krishterë (Serbët, Grekët dhe Bullgarët), ndërkohë që popullata shqiptare (e besimit mysliman, po edhe të krishterët) ishte lënë pas dore ose trajtohej kryekrejt në përputhje me interesat e popujve të krishterë, të cilët në këto vilajete megjithatë shfaqeshin si pakicë, kishte arsye për shqetësim dhe reagime madje. Kjo edhe ndodhte me protestat, revoltën dhe kryengritjet që nuk kishin të ndalur, veçmas në vilajetin e Kosovës.

Lëvizjet popullore në vilajetin e Kosovës, në pjesën që ishte lënë jashtë reformave (dhe këtu bëhej fjalë për disa sanxhaqe të mëdha, siç ishte ai i Prishtinës bashkë me të tjerët që fillonin nga kufiri me Serbinë në veri dhe në jug shtriheshin deri në kufi me Bullgarinë), dhe në atë që përfshiheshin në kuadër të zonës së reformave që i mbikëqyrte Austro-Hungaria (sanxhaku i Shkupit dhe disa kaza të Vilajetit të Manastirit) - pse binin ndesh me Perandorinë Osmane dhe me Fuqitë e Mëdha edhe atëherë kur ruanin kërkesat politike për autonominë shqiptare brenda për brenda Perandorisë Osmane – jo vetëm që nuk e përmirësonin gjendjen, por thellonin pakënaqësinë e popullatës, e cila fitonte bindjen se Serbëve, Bullgarëve dhe Grekëve u bëheshin lëshime sa më shumë që çetat e tyre të vepronin në dobi të krijimit të kaosit.

## “KOMITETI I MANASTIRIT” DHE LUFTA E ARMATOSUR

Përballë këtyre rrethanave - kur në sanxhaqet që tashmë ishin shpallur si “maqedonase” dhe në këtë rajon përplaseshin propaganda të ndryshme nga ajo greke, bullgare, serbe dhe arumune - nacionalistët Shqiptarë domosdoshmërisht do të ndikohen nga lëvizjet sllavo-maqedonase dhe metodat e tyre të luftës me anën e çetave.

---

<sup>1241</sup> HHStA, PA XII/ 312, Kral, Manastir, 3/2/1899.

Nënkonsulli austriak në Manastir, Kral, me të drejtë vërente ndikimin e lëvizjes bullgare mbi disa Shqiptarë, sidomos midis nëpunësve dhe ushtarakëve.<sup>1242</sup> Madje, pak më vonë, Vjenës do t'i raportohet edhe për afri midis të krishterëve shqiptarë dhe atyre bullgarë, që gjithnjë e më shumë përfshiheshin në veprimtarinë e klubeve të tyre, në vend se të zhvillonin një propagandë kombëtare shqiptare. Konsulli austro-hungarez, Kral, njoftonte se edhe Shqiptarët do të fillojnë të organizohen në komitetet të fshehta kryekreje nën ndikimin dhe mbikëqyrjen e lëvizjes bullgare.<sup>1243</sup>

Nuk do të vonojë dhe modeli i çetave dhe i komitëve, tashmë i futur në lojë nga Serbia, Greqia dhe Bullgaria në pjesën e Vilajetit të Selanikut të banuar me shumicë sllavo-bullgare, do të pranohet edhe prej një pjese të Shqiptarëve të Vilajetit të Manastirit, pale se Bullgaria, Serbia dhe Greqia me lëvizjen e komitëve kishin për qëllim krijimin e kaosit me çka do të detyrohej ndërhyrja ndërkombëtare, që për pasojë do të kishte ndarjen e kësaj hapësirë në tri pjesë (atë serbe, greke dhe bullgare) prej nga do të përjashtoheshin Shqiptarë dhe, mbi të gjitha, të pamundësohej çfarëdo projekti për shtetin autonom shqiptar.

Modeli i “luftës çlirimtare” me anën e çetave dhe komitëve, do të përkrahet edhe nga disa qarqe radikale brenda Lëvizjes Xhonturke me orientime revolucionare, të cilët po ashtu ishin të interesuar që në luftë për rrëzimin e despotizmit të Sulltan Hamitit të fusnin në lojë edhe grupet e armatosura nga radhët e Shqiptarëve, nga oficerë të pakënaqur osmanë dhe ushtarakë të tjerë me prejardhje shqiptare, të cilët ishin të interesuar që në këtë mënyrë të përshpejtonin revolucionin me të cilin Xhonturqit do të vinin në pushtet.<sup>1244</sup>

Madje, mund të mos jetë e rastit që në krye të Komitetit të Manastirit të gjenden oficerë të lartë (kolonel Halil bej Berzeshta, nga Korparmata III e Manastirit e të tjerë), që ia dolën që modeli i luftës çlirimtare me anën e çetave dhe grupeve të armatosura, në trekëndëshin e puqjes së Vilajetit të Kosovës, atij të Manastirit dhe të Selanikut, ta hiqte fare atë të kryengritjeve të mëdha gjithëpopullore, që ishin zhvilluar nga Shqiptarët që nga Kriza Lindore e tutje, veçmas nga “Lidhja Shqiptare e Prizrenit” e vitit 1878 e këndej dhe kishin gjetur përkrahjen të madhe edhe nga elita intelektuale në Stamboll dhe ajo që gjendej në diasporë (Rumani, Egjipt dhe tek Italo-Arbëreshët) pse ato mbështeteshin në një program politik gjithëkombëtar që për kërkesë kishte autonominë shqiptare brenda për bren-

<sup>1242</sup> Shih: HHSStA, PA XII/ 312, Kral, Manastir, 3/2/1899.

<sup>1243</sup> Po aty.

<sup>1244</sup> Më gjerësisht rreth frymës revolucionare të Xhonturqve si dhe pranimit të saj nga grupet shqiptare shih te Prifti, Kristaq: “Doktor Ibrahim Temo”, Prishtinë 1996, faqe 106-108; Wernicke, Annemali: “Teodor Ipen dhe Shqipëria në fokusin e Perandorisë Austrohungareze”, Tiranë, 2012.

da Perandorisë Osmane dhe jo rrënimin e saj në përputhje me interesat e vendeve sllave-ortodokse, ku Shqiptarët dilnin humbësit më të mëdhenj.

Lufta klandestine (ilegale) me anën e çetave dhe komitëve të panjohur, edhe pse me moton tërheqës “për çlirim kombëtar”, mundësonte krijimin e atmosferës së kaosit dhe të pasigurisë, pikërisht siç u përshtatej Serbisë, Bullgarisë dhe të Greqisë, ku gishtat e padukshëm mund të futeshin nga të gjitha anët dhe Shqiptarët të luanin lojën e tyre edhe atëherë kur ata mendonin se fjala ishte për një shkallë të lartë të sakrificës patriotike.

Kjo strategji e fqinjëve të Shqiptarëve, të cilët kishin shfaqur haptas pretendimet ndaj vilajeteve të tyre dhe në këtë mënyrë shihnin mundësinë që ato të copëtoheshin, nuk mund të kishte sukses pa konceptin e kaosit, sipas të cilit, ajo që nga ana e tyre projektohej si Maqedoni duhej të kthehej në një “kafene tipike ballkanike”, ku secili vret secilin pa ditur e parë se prej nga vinë plumbat. E vetmja qartësi nga kjo paqartësi ishte ajo që kishte të bënte me parandalimin e krijimit të shtetit autonom shqiptar. Këtij betimi ballkanik, me vetëdije ose pa të, krejt një, do t’i bashkohen edhe shumë Shqiptarë, ngaqë në rrethanat kur fuqitë evropiane përqendroheshin te faktorët e krizës dhe ato që prodhonin ato, e kishin të vështirë t’i iknin provokimit të “kafenesë ballkanike” kur ajo tashmë, me futjen e çetave serbe, bullgare dhe greke në trojet e tyre, po u ndodhte.<sup>1245</sup> Vrasjet e shumta, zullumi si dhe kaosi që do të shkaktohet nga veprimtaria e tyre, do t’i detyrojë shumë nga patriotët që të veprojnë në përputhje me këtë zhvillim. Kështu që veprimtarisë së çetave serbe, greke dhe bullgare, do t’u shoqërohet edhe ajo e Shqiptarëve.

Se a ishte kjo më shumë kundërpërgjigje e domosdoshme ndaj një veprimtarie shturëse dhe rrënuese që vinte nga jashtë, apo ishte pjesë e një strategjie të re, që Lëvizjes Kombëtare Shqiptare ia ndryshonte karakterin, duke e zhvendosur nga kërkesa për barazi, që përkufizohej te autonomia shqiptare përbrenda Perandorisë Osmane, për ta vendosur tek lufta çlirimtare kundër Perandorisë Osmane, kishte diçka nga të dyja.

Por, kjo e dyta, do të dalë në plan të parë, me ç’rast kursi i deriatëhershëm i shtetit autonom shqiptar zëvendësohej thuajse njëanshëm me atë të luftës çlirimtare nga Perandoria Osmane, që do të zhvillohej me metodat e ilegalitetit dhe jashtë ndonjë mbikëqyrje qendrore, pa konsensus gjithëkombëtar dhe as mbështetje te

---

<sup>1245</sup> Sipas shënimeve zyrtare austriake gjatë viteve 1905-1907, në Vilajetin e Manastirit, në sanxhakun e Shkupit të vilajetit të Kosovës, në sanxhakun e Korçës dhe në pjesën jugore të vilajetit të Janinës, në kufi me Greqinë, nga bandat e ndryshme do të vriten mbi 3800 persona, ose një i vrarë në 1500 frymë. (Shih: HHStA, PA XII/ 312).

“Komitetit të Stambollit”, i cili paraqiste bërthamën intelektualë dhe politike të Lëvizjes Kombëtare, qysh nga shfaqja e “Lidhjes Shqiptare të Prizrenit” e këndej.

Ky orientim madje, njëherësh konfrontonte pjesët veriperëndimore (Vilajetin e Kosovës dhe atë të Shkodrës) me ato jug-lindore (Vilajetin e Manastirit dhe atë të Janinës), ose Gegët me Toskët. Meqë të parët edhe më tutje ruanin kursin e lëvizjeve popullore (protestat, kryengritjet e deri te lufta e armatosur siç kishte ndodhur në kohën e “Lidhjes Shqiptare të Prizrenit” e drejtuar nga ushtria e saj që udhëhiqej nga Qeveria e Përkohshme dhe komanda e saj). Ndërsa të dytët, kishin përqafuar klandestinitetin revolucionar si model i sllavo-ortodoksëve, të cilët kishin dy qëllime: rrënimin e Perandorisë Osmane me anën e kaosit të brendshëm, po edhe pengimin e çfarëdo autonomie shqiptare që do të mund të dilte prej saj.

Modelin e klandestinitetit revolucionar (ilegalitetit), i cili në këto anë kishte fituar, e tumiri edhe programi i Komitetit të parë të fshehtë shqiptar “*Për lirinë e Shqipërisë*”, i themeluar në Manastir, në nëntor të vitit 1905, me nismën e Bajram (Bajo) Topullit, nëndrejtor i gjimnazit turk të Manastirit, ku si themelues u përfshinë edhe Halil Bërzeshta, kolonel dhe shef i shërbimit farmaceutik të Korparmatës III, Fehmi Zavalani – pronar, Sejvi Vllamasi (Novosela) – veterinar i qytetit të Manastirit, Gjergj Qiriazhi – përkthyes i konsullatës austriake në atë qytet dhe Jashar Bitincka – mësues gjimnazi, të gjithë këta atdhetarë të një niveli vendor, të cilët pranojnë se nuk kishin bërë konsultime me Komitetin e Stambollit.<sup>1246</sup>

Programi i komitetit “*Kanonizma*”, me anën e krijimit të çetave atdhetare dhe luftës së tyre të armatosur, parashihte çlirimin e Shqipërisë nga robëria osmane, ani pse nuk hiqej dorë edhe nga kërkesat për arsimim në gjuhën shqipe dhe çështjet e tjera, që linin të hapur rrugën e marrëveshjeve me qeverinë osmane, të cilat duhej të bëheshin me detyrimin e armëve.

Për t’u shtrirë në tërë vendin, “*Komiteti i Manastirit*”, dërgoi përfaqësuesit e vet në krahinat e ndryshme të Shqipërisë të Veriut, të Mesme dhe të Jugut dhe vendosi lidhje me dhjetëra atdhetarë shqiptarë, që përkrahën programin e tij kombëtar. Komiteti vendosi marrëdhënie me shoqatat patriotike jashtë vendit, veçanërisht me ato të Bukureshtit e të Sofjes, të cila përkrahën programin dhe veprimtarinë e tyre, meqë ato ishin në përputhje edhe me politikat zyrtare të këtyre shteteve (Bullgarisë dhe të Rumanisë), ku secila në mënyrën e vet përpiqej që të përfitonte

---

<sup>1246</sup> Po aty.

nga kulaçi ballkanik duke instrumentalizuar shqiptare sa më shumë që të ishte e mundur, pale se ata ishin të detyruar disi të reagonin.

Natyrisht se në këto rrethana, programi i “Komitetit të Manastirit”, i cili mbeti thuajse i papërfillur në pjesën më të madhe të Vilajetit të Kosovës dhe të Shkodrës, nuk u përkrah nga Vjena, e cila nuk ishte e interesuar që çështja shqiptare të instrumentalizohej nga vendet sllavo-ortodokse, sidomos Serbia dhe të përdorej për nevoja të tyre, siç po tregohej me rastin e krizës së Maqedonisë, ku Shqiptarët mund të dilnin humbësit më të mëdhenj. Në një udhëzim që Golluhovski, ministër i jashtëm, u dha konsullatave austriake në Shqipëri në prill të vitit 1906, u tha se duhej refuzuar qëllimet revolucionare të Komitetit, duke kërkuar që *“të mos dilte nga caqet e rrugës paqësore dhe të mos përdorte mjetet e dhunës”*<sup>1247</sup>.

Vjena, megjithatë, përkrahu programin kulturor të “Komitetit të Manastirit” dhe i premtoi ndihma financiare për të ngritur shkolla, për të paguar mësuesit, për të botuar libra shqip, për të mbajtur shkollën e vajzave në Korçë dhe për të shtuar numrin e nxënësve të saj.

Ndryshe nga “Komiteti i Manastirit”, që tashmë vepronte në konceptin e “luftës çlirimtare”, nga modelet e strategjive të popujve sllavo-ortodoksë (Serbëve, Grekëve dhe bullgarëve që kishin shtetet kombëtare dhe drejtoheshin prej tyre), në Kosovë vazhduan protestat masive si dhe kryengritjet kundër zbatimit të reformave të Portës së Lartë, veçmas të atyre që kishin për qëllim vjeljen e taksave si dhe çarmatosjen e popullatës.

Në vjeshtën e vitit 1905 ato shpërthyen në Gjakovë, Pejë dhe Prizren, ku krahas kërkesave të njohura politike, shfaqeshin edhe ato kundër taksave të reja që rëndonin gjithnjë e më shumë. Por, ato në një farë mase u qetësuan, pasi që Porta e Lartë shpalli amnisti për të internuarit politikë, që ishin nga Peja, Gjakova, Prizreni e Luma. Në pranverë, megjithatë, ato sërish shpërthyen, kur popullata u ballafaqua me taksat e reja për bagëtinë, për arsimin dhe për blerjen e armatimit për ushtrinë osmane. Kryengritjet nga Dukagjini, në ndeshjen e parë me trupat osmane, që patën 50 të vrarë dhe mbi 200 të plagosur, do të përhapen edhe në sanxhakun e Prishtinës. Gjendja u qetësua kur Porta e Lartë, pas ndërhyrjes të Isa Boletini (që në atë kohë ishte kthyer nga qëndrimi katërvjeçar në Stamboll si kryesoje e pallatit të Sulltanit), premtoi se do të hiqte dorë nga vjelja e taksave të reja.<sup>1248</sup>

---

<sup>1247</sup> “Historia e Popullit Shqiptar”, Tiranë, 2002, faqe 318.

<sup>1248</sup> Po aty, faqe 318.

Heqja dorë nga vjelja e taksave në pjesët e vilajetit të Kosovës të përjashtuara prej reformave do të ndodhë. Perandoria Osmane, siç do t'i premtojë Isa Boletinit, vendosi që gjatë atij viti të mos kërkojë taksë plotësuese. Kjo solli njëfarë paqeje të brishtë, e cila në Kosovë zgjati gjatë gjithë vitit edhe pse ajo do të vazhdojë të provokohet nga çetat serbe dhe ato bullgare që zunë të vepronin në pjesët veriore dhe ato lindore të Kosovës. Atyre do t'u ndihmojë qëndrimi i njohur dyftytrësh i Beogradit, që me njërën anë sy botës të pranohen reformat dhe ato të përkrahën madje, me kusht që të zgjerohen edhe në Kosovë, dhe në tjetrën anë të nxitet veprimtaria e tyre me anën e futjes të grupeve të armatosura nga Serbia. Gjendja do të ashpërsohet në pjesën e Mitrovicës dhe në Sjenicë, ku do të ketë sulme të njëpasnjëshme ndaj stacioneve policore si dhe ndaj pronave të qytetarëve, me ç'rast propaganda e Beogradit fajësonte Shqiptarët.

Megjithatë, gjendja midis pjesëve shqiptare jashtë reformave (pjesës më të madhe të Vilajetit të Kosovës dhe atij të Shkodrës) dhe atyre të përfshira në reforma (sanxhaku i Shkupit nga vilajeti i Kosovës, pastaj Vilajeti i Manastirit dhe pjesa më e madhe e vilajetit të Janinës), shfaqej me ndryshime të dukshme. Sepse, në hapësirën jashtë reformave megjithatë pushteti osman, kishte mbikëqyrje, ndërsa në atë të shpërndarë nën mbikëqyrjen austro-hungareze, ruse dhe italiane, sa vinte e bëhej gjendja gjithnjë e më e turbullt. Shkas për këtë në njërën anë ishin vështrirësitë që fuqitë europiane, të autorizuara për zbatimin e reformave, ndeshnin në pjesë të ndryshme kur refuzoheshin nga popullata vendore, e cila reagonte ndaj tyre në përputhje me udhëzimet që merrte nga jashtë (Serbët nga Serbia, Grekët nga Greqia dhe Maqedonasit nga Bullgaria). Por në tjetrën anë ishte edhe veprimtaria e shtuar e çetave të armatosura, të cilat tashmë më shumë luftonin kundër njëra tjetrës se sa kundër pushtetit osman apo të huajve.

Në këto rrethana, edhe Komiteti "*Për lirinë e Shqipërisë*" doli me platformën për krijimin e "*trupave të armatosura*", siç quheshin çetat e armatosura në këtë dokument. Çetat do të përhapeshin në malet e Shqipërisë, por do të kishin njësitë e tyre të armatosura të fshehta edhe në fshatrat e vendit. Kështu, çeta e parë u krijuar në prillin e vitit 1906 në Kolonjë të Korçës, me 20 luftëtarë dhe e komanduar nga Bajo Topulli. Në Kolonjë u formua edhe një çetë tjetër e komanduar nga Fehmi Zavalani e Sali Butka.<sup>1249</sup>

Radiusi i çetave shqiptare shfaqej nga Kolonja e Korçës e deri në Gorë e Leskovik me prirjen e zgjerimit edhe në pjesët e tjera. Edhe veprimet e para të saj

---

<sup>1249</sup> Po aty, faqe 320.



do të shtrihen në këtë pjesë dhe si më i njohur do të jetë atentati ndaj mitropolitit grek të Korçës, Fotit, që u krye nga çeta e Bajo Topullit dhe u bë, si thuhej, në she-një hakmarrje për masakrimin e atdhetarit Papa Kristo Negovani e bashkëfshatarëve të tij nga kleri shovinist grek.

Qeveria osmane reagoi ndaj veprimtarisë së çetave shqiptare me mjaft ash-përsi dhe efikasitet. Pas disa ndeshjeve me grupe të ndryshme, në të cilat morën pjesë njësitë rezerviste të garnizonit të Manastirit, forcat qeveritare osmane ia dolën të nxjerrin jashtë veprimi çetat shqiptare, të cilat ishin të gjykuara për diçka të tillë ngaqë nuk e kishin “shpinën e fortë”, siç e kishin çetat serbe, bullgare dhe greke, të cilat, kur rrezikoheshin nga ndëshkimi osman, menjëherë tërhiqeshin në Serbi, Bullgari dhe Greqi, ku gjenin mbrojtje. Ndërkaq ato shqiptare nuk kishin mbështetje as në pjesët e Kosovës, sepse “çetat e lirisë” dhe “komitet” të shumtën identifikoheshin me ato serbe dhe bullgare, me të cilat kishin përvojë të keqe dhe shiheshin drejtpërdrejt të drejtuara nga Beogradi dhe kisha ortodokse serbe, që i strehonte.

Kështu, autoriteteve ushtarake osmane, gjatë korriku 1906 u shkoi për dore pa ndonjë mund të madh të burgosin një pjesë të mirë të veprimtarëve të “Komitetit të Manastirit” dhe të përkrahësve të tyre. Midis të arrestuarve pati edhe shumë oficerë të garnizonit ushtarak të Manastirit dhe nëpunës të aparatit shtetëror, që ishin bashkuar me Komitetin. Në janar të vitit 1907 u shpallën në gazetën zyrtare të Vilajetit të Manastirit emrat e atdhetarëve, që duhej të dorëzoheshin e të arrestoheshin sa më parë, ndër të cilët ishte Bajo e Çerçiz Topulli, Beqir e Sali Butka, Islam Anfi, Ahmet Zylfiqari, Dervish Ismaili, Fejzo Beu, Mersin Abdylit e të tjerë.

Kjo bëri që shumë nga ata që kishin formuar çeta ose që drejtonin “Komitetin e Manastirit”, të lëshonin vendin. Ndër ta ishin Bajo e Çerçiz Topulli, që u larguan për në Sofje dhe Bukuresht. Në Bullgari (Rusçuk) u vendos Idriz efendi Gjakova dhe disa bashkëluftëtarë të tjerë.<sup>1250</sup>

Kalimi i vëllezërve Topulli në Sofje dhe në Bukuresht (deri në vitin 1907 prej nga pastaj do të shkojnë në Paris dhe Shtete të Bashkuara të Amerikës), pos që la një gjendje të turbullt në pjesët e Shqipërisë, ku ishte shfaqur veprimtaria revolucionare e çetave, e cila si do të shihet, të shumtën, do t’u shkojë për shtati Bullgarëve dhe Grekëve ta shfrytëzojnë për nevojat e veta, tregoi qartë dobësitë dhe vështirësitë e luftës klandestine karshi veprimtarisë së hapur, siç ishte ajo e protestave dhe e kryengritjeve popullore, që ndiqej nga Lëvizja Kombëtare Shqiptare që

---

<sup>1250</sup> Po aty, faqe 320.

nga fillimet e saj (me rastin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit), të cilat përcilleshin me kërkesa politike për autonominë shqiptare në kuadër të Perandorisë Osmane.

Veprimet e çetave të armatosura të Shqiptarëve, pa adresë të qarta nga brenda dhe me moton e luftës çlirimtare kundër Perandorisë Osmane jashtë një udjie gjithëkombëtare, jo vetëm që nuk gjetën mbështetje të jashtme, por ato u panë me dyshimin, të instrumentalizuara në radhë të parë nga Bullgaria, Greqia dhe Serbia. Këto shtete njësoj do të bëjnë përpjekje ta shfrytëzojnë klandestinitetin shqiptar për hesapet e veta: duke i përdorur nga brenda, ndërsa duke i diskredituar jashtë.

Mbi këto interesa të huaja, me moton “për çlirim” kundër Perandorisë Osmane, Lëvizja Kombëtare Shqiptare, e drejtuar nga “Komiteti i Stambollit”, për herë të parë u sfidua nga një rivalitet i brendshëm mbi bazën e interesave të huaja, që pasqyroheshin me aleanca, që jashtë mbikëqyrjes së saj, do të lidhen në njërën anë me Bullgarët dhe në tjetrën me Grekët, e ku liderët lokalë Bajo Topulli dhe të tjerët, me moton e luftës “për çlirim kombëtar” nga pushtimi osman me anën e çetave ilegale, përpiqeshin t’ua marrin anën liderëve kombëtarë, Ismail Qenali, Hasan Prishtinës dhe të tjerëve, të cilët edhe më tutje Lëvizjes Kombëtare Shqiptare do t’ia ruajnë kërkesën legjitime për autonominë shqiptare në kuadër të Perandorisë Osmane.

Me dëshirë apo pa të, e detyruar nga rrethanat e veçanta që do të paraqiten, apo nga interesat e huaja, do të jetë kjo ndeshja e parë midis konceptit për shtet kombëtar shqiptar, që do të arrihej me anën e barazisë dhe me mjete politike dhe diplomatike pa përjashtuar edhe rezistencën popullore, me atë të çlirimit nga pushtimi osman, me anën e luftës së armatosur me anën e çetave klandestine, të lidhura me Sofjen, Bëgradin dhe Athinën dhe interesat e tyre. Kjo do të ketë pasoja për vetë Shqiptarët, sepse ata më shumë se kurrë, i nxirrte nga kornizat e interesave të Fuqive të Mëdha, ku qëndronin, për t’i bartur te ato të shteteve fqinje, ku nuk mund të pritnin tjetër pos që të bëheshin pre e tyre.

Ishte kjo një kthesë e rrezikshme, që megjithatë, do të pengohet nga Austro-Hungaria, çastin që dukej se kishte filluar ta merrte epilogun tragjik pse ashtu shihet se Shqiptarët dhe çështja e tyre, për të cilën ajo kishte interesa të qarta strategjike dhe kishte investuar shumë që ata të mbaheshin në të, po bëheshin pre e politikës sllavo-ruse.

Para se të vijë deri te ky epilog, Vjena kishte shumë argumente se Sofja dhe Bukureshti, të cilat ndiqnin linjën e një rivaliteti gjithnjë e më të ashpër me Serbinë dhe Greqinë rreth hises më të madhe që duhej ta kishte Bullgaria në Maqedoni, tashmë kishin hartuar edhe plane rreth nxitjeve të çetave shqiptare në vilajetin e

Manastirit dhe atë të Kosovës me qëllim që me anën e tyre të parandalohej ndikimi i Serbisë dhe i Greqisë në këto pjesë, ani pse Bullgaria kishte nënshkruar me Serbinë një marrëveshje për ndarjen e interesave të tyre në vilajetet e Manastirit, të Kosovës dhe të Selanikut me anën e të cilës Kosova dhe Manastiri duhej t'i takonin Serbisë ndërsa një pjesë e madhe e vilajetit të Selanikut t'i bashkëngjitej Bullgarisë.<sup>1251</sup>

Se Sofja nuk fshihte këto qëllime, kjo u pa më së miri nga propozimi që ministri bullgar Genadiev ia bëri Bajo Topullit rreth vendosjes së një bashkëpunimi ndërmjet çetave kryengritëse shqiptare dhe atyre bullgare. Bullgaria bëri të ditur se merrte përsipër furnizimin e çetave shqiptare me armë. Aleanca shqiptarobullgare duhej të përkrahej edhe nga ajo me vllahët, për të cilën ishte e interesuar Rumania. Kolonia shqiptare në Sofje dhe ajo në Rumuni ishin shumë të interesuara për këtë bashkëpunim dhe do t'i japin mbështetje të gjerë.<sup>1252</sup>

Gazeta “Drita” e Sofjes që udhëhiqej nga Shahin Kolonja, ishte zëdhënësja më e fuqishme e kësaj aleance. Duke theksuar vazhdimisht interesin e Bullgarisë për një ndarje të Maqedonisë me Shqiptarët, do të kthehej në organ të Komitetit “Për lirinë e Shqipërisë”. Çerçiz Topulli në shkrimin “Ndjenjat e një mëmëdhetari” ngrihte zërin rreth nevojës që “toskë e gegë, të krishterë e muhamedanë, të dalim maleve, të luftojmë deri në vdekje, dhe të bëjë që të dëgjohet zëri i kryengritjes që nga Preveza e gjer në kufijtë e Serbisë e të Malit të Zi”.<sup>1253</sup>

Kjo gazetë dhe të tjerat (“Kombi”, Boston dhe “Shpresa e Shqypnisë”, Raguzë-Trieste-Romë) do të kenë shkrime të ngjashme, por që jo kudo do të përkrahen ose do të priten me jehonë pozitive. Sepse, jo të gjithë atdhetarët shqiptarë mbajtën të njëjtin qëndrim ndaj luftës së armatosur të çetave, veçmas kur dihej se kush i kishte gishtat në to, dhe kur dihej se çfarë do të thoshte heqja dorë nga koncepti i krijimit të shtetit autonom shqiptar në kuadër të Perandorisë Osmane në dobi të pavarësisë nga Perandoria Osmane me anën e “një lufte çlirimtare”, e cila, edhe po t'i kishte kushtet e brendshme, nuk do të lejohej nga shtet fqinje e as nga Rusia, pos që do të shfrytëzohej si alibi për copëtimin e tokave shqiptare, siç do të ndodhë në të vërtetë gjatë Luftës së Parë Ballkanike.

---

<sup>1251</sup> Më gjerësisht rreth traktateve midis Serbisë dhe Bullgarisë dhe Malit të Zi shih: Čorović, Vladimir: “Borba za nezavisnost Balkana”, Beograd, 1936, faqe 112-127; Jovanović, Jovan M.: “Borba za narodno ujedinjanje 1903-1908”, Beograd, 1938; Aleksić P. Liljana: “O sprsko-crnogorskom programu o savezu 1904-1905”, Beograd, 1965; Dragnich, A. N: and Todorovich, S: “The Saga of Kosovo: Focus on Serbian-Albanian Relations”, New York, 1984.

<sup>1252</sup> Shih gazetën “Drita”, Sofje, dhjetor, 1906.

<sup>1253</sup> “Drita”, dhjetor 1906, Sofje.

Faik Konica, në revistën “Albania”, që ishte ndër organet kryesore të shtypit shqiptar, botoi disa shkrime kundër orientimit të luftës çlirimtare me anën e çetave. Në disa shkrime (“Mendime të fundit të motit”, “Bajo Topulli dhe politika e asasinatëve”), luftën me anën e çetave të padukshme do ta uajë “të kotë dhe të dëmshme”.

Konica, si intelektual i lartë dhe si njohës i mirë i lojërave diplomatike, veçmas i atyre që lidheshin me kurdisjet e shumta të fqinjëve të Shqiptarëve që ata të përdoreshin për qëllimet e tyre, thoshte:

*“Udha më e shkurtër dhe më e mbarë për çlirimin e Shqipërisë është përhapja në popull e shkrimit dhe e këndimit shqip, e dijeve dhe diturisë”.*<sup>1254</sup>

Siç pritej, krahas Bullgarisë interesim për çetat shqiptare dhe për përfshirjen e Shqiptarëve në modelin e destabilizimit të mëtutjeshëm të Perandorisë Osmane në Maqedoni, do të tregojë edhe Greqia. Kjo pritej, sepse edhe Athina, pareshtur pretendonte që ta përvetësonte një pjesë të mirë të territoreve shqiptare. Për këtë qëllim ajo luante me kartën e Arvanitasve (Shqiptarëve autoktonë në Atikë, More dhe ishujt e Egjeut), por edhe të Shqiptarëve të besimit ortodoks në vilajetin e Janinës, të cilët përbënin shumicën e popullatës në shumë kaza të këtij vilajeti dhe në luftën e ashpër midis ekzarkatit bullgar dhe Patrikanës greke, kishin marrë anën e kë-saj të dytës, sidomos në Shqipërinë e Jugut dhe atë të Mesme, me ç’rast, për t’i ikur çfarëdo identifikimi me sllavo-maqedonasit, ortodoksët shqiptarë përcaktoheshin kah kisha greke dhe helenizmi, paçka se prapa të cilit fshihej helenizimi dhe interesat greke.

Pasi që të kenë dështuar përpjekjet e Athinës që me anën e përhapjes së idesë së një “mbretërie dualiste greko-shqiptare” t’i përfshinte ata në projektet e saj helenizuese, politika e këtij vendi, në përputhje me zhvillimet më të reja, doli me kërkesën për vendosjen e një aleance të re greko-shqiptare, që siç u tha, ishte në interes të dy popujve. Përveç organizatës “Lidhja shqiptaro-greke”, që tubonte Arvanitasit, në Athinë filloi punën edhe shoqata “O Ellenismos” (Helenizmi), e kryesuar nga Neoklis Kazazis (Nikolla Kazazi), Arvanitas, profesor me renome të lartë shoqërore në Greqi.

Kjo shoqatë në program kishte, siç thuhej “përpjekjet që të dy popujt të angazhoheshin për interesa të përbashkëta”. Mbi këto parime “O Ellenismos” do të botojë një broshurë drejtuar “vëllezërve Shqiptarë të Shqipërisë”, të shkruar nga Sekos, Boçari dhe Xhavella, arvanitas të njohur, që vinin nga familje që i kishin kontribuar krijimit të shtetit grek.<sup>1255</sup>

<sup>1254</sup> “Albania”, nr. 8 dhe nr. 11/1906.

<sup>1255</sup> “Prokirixi tou Arvanitikou sindesmou tis Athinas pros tus Aderfous arvanaites tis Arvanitias”, Athina, (Etarireia “O Ellenismos”), faqe 19 në HHStA, PA XXXVIII/443.

Idetë që shtjelloheshin në “*O Ellenismos*” i shin si vijon: bij të Aleksandërit të madh dhe të Skënderbeut, të gjithë Shqiptarët ishin vëllezër, të gjitha kombet po njihnin një rilindje, por Shqiptarët e kishin të pamundur të jetonin të vetëm dhe të formonin një shtet të tyrin, sepse ata ishin shumë të varfër dhe nuk kishin as letërsi, as një fe të vetme; duke pasur parasysh se Shqiptarët dhe Grekët kishin një histori të përbashkët - Arvanitët kishin çliruar Greqinë dhe “*greku përpara se ti ishte grek kishte qenë shqiptar, do të thotë pellazg*” - do të ishte e natyrshme një e ardhme e përbashkët, në formën e një mbretërie greko-shqiptare sipas modelit të Austro-Hungarisë.<sup>1256</sup>

Përfundimi ishte i qartë: “*shikoni, vëllezër, se sa arsye të rëndësishme kemi për t’u bashkuar me Grekët dhe asnjë për të mbështetur zgjedhën italiane, austriake, vllahë, malazeze, serbe apo bullgare*”<sup>1257</sup>

Fillimisht, nga këto parime do të udhëhiqet edhe Ismail Qemali. Duke synuar të siguronte përkrahjen e saj kundër invadimit të mundshëm sllav, të Serbisë dhe të Bullgarisë, që cenonin interesat shqiptare në vilajetet e Kosovës e të Manastirit dhe ato greke në Maqedoni, arriti të lidhte një marrëveshje për bashkëpunim shqip-tarogrek.<sup>1258</sup>

Bisedimet e para për një aleancë shqiptaro-greke, Ismail Qemali i kishte filluar më herët, qysh gjatë qëndrimit të tij të parë në Athinë, në vitin 1900, menjëherë pas emigrimit nga Perandoria Osmane. Nga ajo kohë e këndeje, gjatë qëndrimit jashtë Turqisë (deri në vitin 1908), ka shumë të dhëna se ai rregullisht mori të holla të konsiderueshme nga Greqia.<sup>1259</sup>

Në vitin 1906, me kryetarin e “*O Ellenismos*” (Helenizmit) Nikolla Kazazi dhe me personalitete të tjera greke, I. Qemali pati disa biseda rreth kësaj çështje. Pak më vonë, pra në shkurt të vitit 1907, ato përfunduan me një aleancë apo lidhje shqiptaro-greke. Tezat kryesore të saj u shpallën në një manifest të posaçëm më 4 prill 1907. Komunikata e publikuar në shtypin e Athinës, u bë në emër të “*Komitetit të Lidhjes greko-shqiptare*”.<sup>1260</sup>

Në të dyja këto dokumente vihej theksi në interesimin e përbashkët të Grekëve dhe të Shqiptarëve, si popujt më të lashtë të Gadishullit Ballkanik, për t’u mbrojtur nga një agresion i ardhshëm bullgaro-serb. Shqiptarët dhe Grekët

---

<sup>1256</sup> Po aty.

<sup>1257</sup> Shih: “*Prokīrīxi tou Arvanitikou sindesmou tis Athinas pros tus Aderfous arvanaites tis Arvanitias*”, Athina, (Etairēia “*O Ellenismos*”), faqe 19 në HHSa, PA XXXVIII/443.

<sup>1258</sup> “*Historia e popullit shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 328.

<sup>1259</sup> Clyer, Nathalie: “*Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*”, Tiranë, 2009, faqe 449.

<sup>1260</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, Tiranë, 2002, faqe 328.

angazhoheshin që të respektonin *status quo-n* në Lindje, të përkrahnin reformat e Fuqive të Mëdha, por me kusht që ato të ishin më radikale dhe për të gjithë popujt e Perandorisë Osmane.<sup>1261</sup>

Sipas B. Kondis, qeveria greke e kishte ofruar Ismail Qemalin me qëllim që të arrihej një marrëveshje e fshehtë, që do të vendoste përcaktimin e kufirit të ardhshëm midis Greqisë dhe Shqipërisë, në këmbim të mbështetjes që shteti grek do t'i jepte krijimit të një Shqipërie të pavarur. Në të njëjtën kohë, sipas konsullit grek në Shkodër, Greqia kishte menduar të hapte një katedër të shqipes në Universitetin e Athinës me qëllim që të themelonte një gazetë dygjuhëshe, që do t'i kushtojë promovimit të arritjes së një marrëveshjeje me të cilën do të arrihej mirëbesimi i Shqiptarëve ndaj politikës greke, e cila vetëm me veprime të tilla mund të dëshmohej.<sup>1262</sup>

Por, pa u tharë ngjyra në marrëveshjen që kishte nënshkruar Ismail Qemali me Greqët rreth lidhjes shqiptaro-greke, kryeministri grek Teodokis, gjatë takimit me të dërguarin e Vjenës në Athinë, shprehu haptas pretendimet greke për Epirin (Shqipërinë e Jugut), me çka edhe një herë Athina zyrtare dëshmoi se marrëveshjet me Shqiptarët nuk i kishte për të mirë të tyre, por që t'i instrumentalizojë për qëllimet e veta.<sup>1263</sup>

Bashkëpunimi dhe aleanca që Ismail Qemali lidhi me Greqinë, sado që ajo nuk kishte ndonjë fuqi obliguese për Shqiptarët, meqë prapa “parafit” nuk qëndronte asnjë shoqatë apo komitet shqiptar, u kundërshtua nga qarqet atdhetare shqiptare, sidomos nga Faik Konica, një pjesë e shtypit italo-arbëresh dhe nga ai në Sofje dhe Bukuresht, i cili mbronte aleancën e Shqiptarëve me Bullgarinë.

Gazeta “*Drita*” e Shahin Kolonjës shfaqej shumë e ashër në gjykimin e çfarëdo lidhjeje me Greqët, meqë aty shihte edhe interesat serbe, të cilat ishin në harmoni me njëra-tjetrën kundër çështjes shqiptare.

Ismail Qemali si diplomat i profesionit dhe politikan i rryer, i cili kërkonte që të gjente interesin më të përshtatshëm midis balancave të Fuqive të Mëdha dhe atyre ballkanike, ku ai llogariste se një aleancë e mundshme midis Greqëve dhe Shqiptarëve ishte edhe interes i Britanikëve dhe Italianëve dhe, ata tashmë kishin parasysh këtë dhe madje në njëfarë mënyre edhe luanin në këtë kartë, më në fund e kuptoi se Greqia edhe kur duhej të luftonte për hesapet e veta në raport me Serbinë dhe Bullgarinë dhe - këtë mund ta bënte duke u mbështetur tek Shqiptarët - më

---

<sup>1261</sup> Po aty, faqe 328.

<sup>1262</sup> Clayer, Nathali: “*Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*”, Tiranë, 2009, faqe 450.

<sup>1263</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 328.

lehtë pranonte të sakrifikoje Shqiptarët në dobi të Serbëve apo bullgarëve se sa t'i bënte për vete, duke ua njohur të drejtat që u takonin. Kjo ndikoi që Ismail Qemali përfundimisht t'i kthehet Austro-Hungarisë dhe të mbështetet te ajo, si të vetmes që në ato rrethana Shqiptarëve mund t'u ndihmonte që të mos mbeteshin pre e gllabërimit të fqinjëve dhe kurtheve të tyre të njohura.

Se pjesë të ndryshme nga radhët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në ato rrethana shumë dramatike mund të vepronin kryenëvete dhe me naivitet do të përfshihen në çështjen maqedonase për t'u bërë pjesë e interesave të huaja, këtë do ta kuptojë edhe Bajo Topulli, pasi që të ketë qëndruar në Sofje dhe në disa vende të tjera. I ndikuar nga rrethanat dhe, duke parë se Shqiptarët dhe çështja e tyre ndodh nën trysinë e vazhdueshme të manipulimit nga jashtë, veçmas nga vendet fqinje, të cilat kishin interesat kryesore jo që Shqiptarët të fitonin lirinë dhe pavarësinë e tyre, por që t'u copëtoheshin trojet, Bajo Topulli, në vitin 1907, u deklaroi përfaqësuesve të Vjenës se “*situata në Shqipëri ende nuk ishte pjekur për një kryengritje të përgjithshme*”, por për ta përgatitur atë komitetet “*Për lirinë e Shqipërisë*”, do të vazhdonin të organizonin çeta të armatosura, të cilat, megjithatë, nuk do të ndërmerren akte terroriste dhe do të merreshin me përhapjen e ideve kombëtare të Shqiptarëve”.<sup>1264</sup>

Në ato vite kritike, Shqiptarët e përcaktuar për luftën me anën e çetave dhe të veprimeve klandestine, e kuptuan fare mirë se e kishin vështirë t'u iknin manipulimeve që u vinin nga rivalitetet midis Serbisë, Bullgarisë dhe Greqisë. Qe t'i ikin këtij kurthi, me çka Lëvizjes Kombëtare Shqiptare i ruhej kompas i njohura politike - për autonominë shqiptare, do t'i ndihmojë përballja me Komitetin Xhonturk dhe përcaktimin që të rrënohej qeverisja despotike e Sulltan Hamitit, por jo edhe Perandoria Osmane, siç kërkonin Serbët, Grekët, bullgarët.

## SHQIPTARËT DHE FORMIMI I KOMITETIT “BASHKIM DHE PËRPARIM”

Meqë kriza maqedonase kishte krijuar një terren të përshtatshëm për përhapjen e komiteve të ndryshme, qëllimi i të cilave ishte rrënimi i Perandorisë Osmane me anën e krijimit të kaosit të përgjithshëm, ishte e natyrshme që aty të kishte vend edhe për Komitetin “*Bashkim dhe Përparim*” (KBP), i cili pas bashki-

---

<sup>1264</sup> Po aty, faqe 323.

mit të Shoqërisë “*Osmanët e lirisë*” dhe Shoqërisë “*Përparimi dhe Bashkimi*” në shtator të vitit 1907, shfaqej në një rol të trefishtë:

- që të luftonte për kthimin e rendit kushtues me anën e rrëzimit të despotizmit hamitian,

- që të luftonte veprimtarinë e çetave serbe, greke dhe bullgare dhe

- njëherësh të mbronte Perandorinë Osmane nga shkatërrimi.

Komiteti “*Bashkim dhe Përparim*”, këtë platformë e kishte arritur kohë më parë dhe pas bashkimit ishte e natyrshme që t’i kushtonte vëmendje të madhe marrjes së mbështetjes shqiptare, duke qenë plotësisht i vetëdijshme për faktin se pa mbështetjen e popullsisë shqiptare, e cila përbënte një pjesë të konsiderueshme të popullsisë me besim mysliman në provincat europiane, sukcesi do të ishte i pamundur.<sup>1265</sup>

Në ato rrethana, edhe interesat e Shqiptarëve, në masë të madhe, përputheshin me ato të Turqve të Rinj. Kjo shihej qartë edhe nga përfshirja e Shqiptarëve në këtë lëvizje që nga shfaqja e saj e parë në vitin 1889 e këndeje, madje si themelues të saj, të cilët, do t’i ndihmojnë shtrirjes dhe ngritjes së saj në të gjitha fazat.

Në kongresin e Parisit të dhjetorit të vitit 1907, Xhonturqit rikonfirmuan qëndrimin ndaj mbështetjes shqiptare dhe këtë e bënë duke iu drejtuar atyre me një komunikatë në gjuhën shqipe, që kishte një domethënie të madhe, meqë bëhej me dije se me rastin e fitores Shqiptarët do të gëzonin tretmanin e barabartë me të tjerët, që ishte njëra prej kërkesave kryesore të Shqiptarëve në luftë për autonomi. Nëse kihej para sysh se Sulltan Hamiti, Shqiptarëve ua dinte rëndësinë, se ata i konsideronte mbështetës të Perandorisë Osmane në pjesën europiane, ndërkohë që vetëm atyre ua ndalonte shfaqjen e identitetit kombëtar dhe ua merrte edhe ato pak të drejta që fillimisht ua kishte lejuar në fushën e emancipimit, atëherë komunikimi i parë në shqip i Xhonturqve me Shqiptarët paraqiste një kthesë të madhe të dyanshme për afri e mirëbesim, që ishte i domosdoshëm që edhe Shqiptarët t’i bashkoheshin lëvizjes opozitare dhe me të t’i harmonizojnë dhe bashkërendisin kërkesat e tyre politike, shoqërore dhe kulturore. Në Paris, po ashtu, doli qëndrimi se përkrahej qëndresa e armatosur ndaj politikës shtypëse të qeverisë, me çka për ta rrëzuar nga fronti Sulltan Hamitin lejohej edhe dhuna revolucionare, e cila deri atëherë ishte përjashtuar.

Kjo kishte rëndësi për Shqiptarët, veçmas për atë pjesë të përshkruar nga fryma revolucionare që tashmë me çetat e tyre ishin përfshirë në këtë zhvillim, dhe se kursi bashkëveprues me Xhonturqit për ruajtjen e kalifatit dhe me thirrjen për

---

<sup>1265</sup> Gawrych, Georg: “*Gjysmëhëna dhe Shqiponja*”, Tiranë, 2007, faqe 222.



një qeveri të zgjedhur nga një parlament, që do të zinte vendin e regjimit despotik,<sup>1266</sup>ata i shkëpuste nga instrumentalizimi që u vinte nga Serbët, Bullgarët dhe Grekët, të cilët ishin shumë të interesuar që edhe Shqiptarët t'i fusnin në lojën e kaosit ballkanik. Ndërsa edhe pjesës fanatike ia hiqte frikën se kthimi i kushtetutës dhe i parlamentarizmit nuk do të thoshte rrënim i Sulltanatit dhe kalifatit e bashkë me të edhe kthimin e laicizmit. Në të vërtetë, tonet pajtuese rreth ruajtjes së Sulltanatit dhe kthimit të rendit kushtetues do të pajtojnë edhe vetë Shqiptarët e ndarë në taborin e Sulltanit dhe të opozitës.

Meqë të tria këto parime ishin të pranueshme edhe për Shqiptarët dhe ato përkonin me përcaktimin që interesat e tyre të zgjidheshin brenda Perandorisë Osmane, mundësisht në marrëveshje me të dhe Fuqitë e Mëdha, si mbikëqyrës, dhe jo me rrënimin e saj të menjëhershëm, ngaqë ashtu kërcënoheshin të ktheheshin në pre të vendeve fqinje, të shumtë ishin Shqiptarët myslimanë që u rreshtuan me rrjetet xhonturke, sidomos në vilajetin e Kosovës dhe në sanxhaqet ku kishte pakicë maqedonase, po edhe në vilajetin e Janinës dhe, në një masë të vogël, edhe në vilajetin e Shkodrës. Në veçanti, ushtarakë dhe nëpunës, u bënë anëtarë të degëve të ndryshme të KBP që po krijoheshin gjithandej. Kjo shtresë shoqërore jo vetëm që drejtpërdrejt ballafaqohej me luftën që bënte kundër çetave serbë, bullgare dhe greke për ta ndaluar kaosin në të cilën zhytej vendi, por e kuptonte më së miri se ishin Shqiptarët ata të cilët do të binin pre e këtij zhvillimi po qe se do të vazhdonte edhe më tutje.

Në Shkup, djali i një anëtari të parisë, Nexhip Draga, ish nxënës i *Mykijes* (*Mykije*), u bë njëri ndër njerëzit e fortë të Komitetit për “Përparim dhe Bashkim” (KBP). Në Mitrovicë, Sylejman Kylçe, një oficer i ri me prejardhje nga Tetova, iu bashkua gjithashtu celulës lokale.<sup>1267</sup>

Komiteteve të Xhonturqve po u bashkoheshin dhe po bënë propagandë për ta bektashinjtë anëmbanë Kosovës. Ata ishin një faktor i rëndësishëm për t’ia hapur rrugën bashkimit të mëtutjeshëm të Shqiptarëve me Turqit e Rinj, kur dihej se ky sekt, i rënuar brutalisht nga Sulltan Mahmuti II më 1826, përkrahte Lëvizjen Kombëtare Shqiptare dhe përpjekjet e saj për autonomi përbrenda Perandorisë Osmane.

Megjithatë, ajo pjesë e Lëvizja Kombëtare Shqiptare, që kishte marrë drejtimin e luftës çlirimtare dhe ishte përcaktuar për futjen në veprim të çetave

---

<sup>1266</sup> Po aty, faqe 222.

<sup>1267</sup> Clayer, Nathali: “*Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*”, Tiranë, 2009, faqe 514.

shqiptare kundër Perandorisë Osmane, të cilat praktikisht ishin ndërlikuar në rivalitetin bullgar, atë grek dhe serb, pas shfaqjes së qendrës së Shoqërisë “*Përparim dhe Bashkim*” në Selanik në verën e vitit 1906, që luante rolin e një komiteti qendror për Turqinë europiane dhe zhvillonte një propagandë të gjerë në vilajetet e Rumelisë, duhej të përcaktohej për bashkëpunim dhe bashkëveprim me Turqit e Rinj ose për luftë kundër tyre.

Kjo e dyta njëherësh do të thoshte edhe shkëputje nga krerët kryesor të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe kursi i saj i njohur për barazi dhe autonomi shqiptare në përbërje të Perandorisë Osmane, sepse Shoqëria “*Përparim dhe Bashkim*”, jo vetëm që për themelues kishte shumë nga patriotët shqiptare në krye me Ibrahim Temon, por ata vazhdonin të mbeteshin drejtues të saj, siç ishte Ismail Qemali, Hasan Prishtina dhe të tjerë, që përpiqeshin që në këtë lëvizje të ndër lidhin edhe interesin shqiptar.

Me ashpërsimin e krizës së Maqedonisë, e kushtëzuar nga intensifikimi i vepërimit të çetave serbe, bullgare dhe greke në vilajetet shqiptare, që kërcënonte shpërthimin e një konflikti ndërballkanik dhe për pasojë do të kishte shkëputjen e kësaj pjese nga Perandoria Osmane dhe ndarjen midis vendeve ballkanike sipas një skenari tashmë të njohur në përputhje me marrëveshjet midis tyre (Serbisë, Bullgarisë dhe Greqisë), Shqiptarët tashmë të “revolucionarizuar” duhej të zgjidhnin midis interesit shqiptar, që në ato rrethana ishte në përputhje me atë të Xhonturqve (rrëzimi i absolutizmit të Sulltan Hamitit dhe kthim i rendit kushtetues, që nënkuptonte edhe mbrojtjen e Perandorisë Osmane nga copëtimi), dhe atij të instrumentalizimit të mëtutjeshëm nga Serbët, Bullgarët dhe Grekët, pa kurrfarë garancish se mund të fitohej diçka, pos zhytjes në gjendjen e një pasigurie të plotë, që mund të pasonte pas shembjes së Perandorisë Osmane.

Kjo dilemë do të hiqet në dhjetorin e vitit 1907, pas mbajtjes së Kongresit të Dytë të Turqve të Rinj në Paris, të cilët pranojnë kryengritjen e armatosur si mjet lufte *vetëm* kundër absolutizmit të Sulltanit dhe për rivendosjen e kushtetutës.<sup>1268</sup>

Ky “kompromis” ishte i rëndësishëm ngaqë çetave shqiptare dhe të tjerave, u jepej mundësia që “revolucionaritetin” ta ushtrojnë edhe më tutje. Këtë herë jo për luftë “çlirimtare” dhe për ta rrënuar Perandorinë Osmane, siç synonin shtete ballkanike (Serbia, Greqia, Mali i Zi dhe Bullgaria) të dirigjuara nga Rusia, por për të luftuar despotizmin e Sulltan Hamitit dhe kthimin e parlamentarizmit. Bëhej, pra fjalë për një “revolucion demokratik”.

---

<sup>1268</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 373.

Përcaktimi i ri, si edhe premtimet që u erdhën shqiptarëve, Maqedonasve dhe të tjerëve, nga kongresi i Parisit, që bashkë me kushtetutën do të fitonin “*lirinë, barazinë, vëllazërimin dhe drejtësinë*”, i siguruan udhëheqjes xhonturke përkrahjen e këtyre popujve, në mënyrë të veçantë të Shqiptarëve, përkrahje kjo që do të jetë vendimtare për kahun përfundimtar të revolucionit.<sup>1269</sup>

Në Pranverën e verën e vitit 1908, në një varg qytetesh të Shqipërisë: në Ohër, Prespë, Strugë, Manastir, Shkup, Gjirokastrë, Shkodër, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë etj., krahas komiteteve kombëtare “*Për lirinë e Shqipërisë*”, u formuan edhe komitetet xhonturke “*Bashkim dhe Përparim*”. Në to gjenin vend bashkërisht intelektualët dhe oficerët Shqiptarë. Ishte kjo një përpjekje e suksesshme, që lëvizja legale opozitare, siç ishte ajo që drejtohej nga Turqit e Rinj (e ku Shqiptarët kishin një rol të rëndësishëm), të bënte për vete dhe të kthente në mjet të vetin të mbi-këqyrur edhe “*revolucionaritetin ilegal*”, jo vetëm të çetave dhe të komitëve nga radhët e Shqiptarëve dhe sllavo-maqedonasve, por edhe atë që kishte zënë të shfaqej si revoltë e hapur edhe nga radhët e ushtarakëve osmanë të pakënaqur me gjendjen kaotike në Maqedoni. Kështu që, suksese më të mëdha Turqit e Rinj siguruan në repartet ushtarake, sidomos midis oficerëve e ushtarëve Shqiptarë, të cilët ishin të vetëdijshëm se rebelimi i tyre duhej përdorur dhe drejtuar për ta kthyer rendin kushtetues dhe jo për ta rrënuar Perandorinë Osmane.

Mbi këto qëndrime, shumica e oficerëve Shqiptarë të garnizonit të Shkupit përkrahu lëvizjen e Turqve të Rinj. Ngjashëm ndodhi edhe në shumë garnizone të Armatës së II të Selanikut, e cila vlerësohej si më e përgatitura ushtarakisht dhe ishte përgjegjëse për mbrojtjen e pjesëve europiane të Perandorisë.

Pas proklamatës që ushtaraku shqiptar, koloneli Ahmet Njaziu, dhe Komiteti “*Bashkim dhe Përparim*” e përhapën në ditët e para të korrikut të vitit 1908 në qytetet dhe fshatrat e Shqipërisë, ku thuhej se synimi i tyre ishte të shpallnin kushtetutën dhe me këtë akt “*t’u siguronin gjithë popujve të Perandorisë, pa dallim feje, lirinë, barazinë, vëllazërimin dhe drejtësinë*”,<sup>1270</sup> ndërsa Shqiptarëve iu

---

<sup>1269</sup> Po aty, faqe 375.

<sup>1270</sup> Kolonel *Ahmet Njaziu*, ishte një ushtarak me origjinë shqiptare që u bë një nga heronjtë e revolucionit të 1908. I lindur në vitin 1873 në rajonin e Resnjës, në Jugperëndim të Manastirit, ai kishte studiuar në *idadijen* ushtarake të Manastirit, ku kishte ardhur në kontakt me ndjenjën e patriotizmit osman. Kishte ndjekur shkollën ushtarake të kryeqytetit, të cilën e kreu me sukses. Karrierën e ushtarakut e kishte filluar në Ohër, ku do të arrijë gradën e kolonelit. Si ushtrak, më 1879 kishte marrë pjesë në luftën kundër Greqisë. Në prag të Revolucionit Xhonturk, kolonel Ahmet Njaziu do të dalë në mal dhe aty kishte filluar t’i përdorte çetat shqiptare, që i quante “*Komiteti toskë i Çerçizit*”, me çka ai ia doli mbanë që çetat shqiptare t’i shkëputte nga çfarëdo lidhjeje me çetat sllave (sllave, bullgare ose greke) dhe t’i të bashkonte me çështjen e përbashkët disa ditë para shpalljes së Kushtetutës.

premtua se do t'i çlironin nga taksat dhe do t'i shpëtonin nga arbitrariteti i nëpunësve, lëvizja shqiptare me frymë revolucionare filloi të shkëputet nga rrjeti ballkanik i veprimtarisë klandestine të luftës së çetave dhe komitëve sipas modelit serb, bullgar dhe grek, për t'u bartur në valët e një kryengritje të hapur, që bëhej nga opozita për ta përmbysur regjimin absolut të Sulltanit dhe për ta kthyer kushtetutën dhe parlamentarizmin.

Ishte kjo një kthesë tjetër e rëndësishme kur ata që deri më dje betoheshin se me luftë do ta çlironin Shqipërinë nga Perandoria Osmane, tash betoheshin se luftën do ta përdornin vetëm për rrëzimin e despotizmit të regjimit të sulltan Hamidit dhe kthimit të rendit kushtetues të përmbysur prej tij para tridhjetë e dy vitesh.

Komiteti i fshehtë i Manastirit "*Për lirinë e Shqipërisë*", duke pranuar ofertën e Komitetit "*Bashkim dhe Përparim*" për të bashkëvepruar, në njëfarë mënyre iu kthye parimeve të mirëfillta të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare si dhe kërkesave të saj legjitime të shprehura qysh nga "Lidhja Shqiptare e Prizrenit" për autonominë shqiptare në përbërje të Perandorisë Osmane.

Me këtë veprim, Shqiptarët, të cilët nga Kryengritja e "Ilindeni" e vitit 1903 dhe ato që prodhoi ajo, në emër të interesave bullgare, serbe dhe greke, rrezikonin të marginalizoheshin në rivalitetin e interesave të vendeve ballkanike dhe të instrumentalizoheshin prej tyre, serish do të kthehen në binarët historik si akterë të saj të rëndësishëm.

## REVOLUCIONI XHONTURK DHE ROLI I SHQIPTARËVE NË TË

Në Revolucionin Xhonturk të korrikut të vitit 1908, Shqiptarët luajtën një rol të madh, në mos vendimtar për suksesin e tij. Ata morën pjesë në revolucion si osmanë dhe si Shqiptarë. Ky dualizëm është i një rëndësie të veçantë, meqë shpjegon suksesin, por edhe dështimin e mëvonshëm të Revolucionit. Shpjegon pajtimet fillestare dhe mospajtimet midis tyre, që do të sjellin edhe konfliktin midis Shqiptarëve de Turqve të Rinj, që për pasojë do të ketë krizën ballkanike dhe shembjen e Perandorisë Osmane.

Çështja pse Shqiptarët në Revolucionin Xhonturk morën pjesë si Osmanë dhe njëherësh si Shqiptarë paraqet rrugën e gjatë të kuptimeve dhe moskuptimeve të tyre me Perandorinë Osmane, që do të kalojnë nga qartësimi i raporteve me islamizmin si koncept që bashkonte fenë me shtetin e deri te osmanizmi, si patriotizëm

shtetëror, që do të përqafohet nga Xhonturqit, por njëherësh paraqet edhe arritjen e një shkalle të Shqiptarëve si komb politik.

Në këto ngjarje rol vendimtar do të luajë procesi i zgjimit kombëtar i Shqiptarëve drejt një vetëdije shoqërore dhe politike, që ishte në përputhje me zhvillimet, që u shfaqën pas reformave të Tanzimatit, si një kthesë kyçe drejt lëvizjeve nacionale që do të nxisin ato tek popujt e Ballkanit.

Të gjendur përballë atyre rrethanave vendimtare, Shqiptarët duhej të vendosnin: të mbeteshin në kuadër të *milleti-osman* me identitetin islam, që do t'i lente përgjithmonë në Lindje, ku i priste asimilimi i plotë? Ose të ndaheshin prej tij? Rruga e dytë domosdoshmërisht kërkonte përcaktim kombëtar mbi identitetin etnik, kulturor dhe qytetëruar.

Ishte kjo sfida e parë e një rëndësie historike që Shqiptarët përballeshin seriozisht prej më shumë se katër shekujsh sa gjendeshin në përbërje të Perandorisë Osmane. Rëndësia e saj ishte edhe më e madhe, pasi që ajo kalonte nëpërmes një ballafaqimi të brendshëm, nga shkakut se shumica e tyre tashmë kishin përqaftuar islamit dhe kështu ishin përfshirë në kornizat e konceptit të tij politik (me tretmanin e milletit-osman) dhe në atë civilizues, paçka se me asnjërin nuk ishin identifikuar plotësisht.

Siç është parë dhe shpjeguar më lartë, Shqiptarët do të qartësohen me islamizmin nga aspekti identitar edhe me ndihmën e vetë islamizmit, i cili në rrethanat perandorake nuk mohonte identitetet kulturore dhe etnike, por mund të ishte përcaktues në rrethanat e reformave të Tanzimatit kur osmanizmi kthehej në një vetëdije të patriotizmit shtetëror, i cili ngrihej mbi doktrinën e nacionalizmit turk.

Nëse mund të thuhet se qartësimin me islamizmin si vetëdije që lidh besimin me vatanin, Shqiptarët do ta përballojnë disi në saje të filozofisë politike të Sami Frashërit e pranuar nga Rilindasit se dashuria për atdheun, në rastin konkret Shqipërinë, nuk bie në kundërshtim me besnikërinë ndaj vatanit (Perandorisë Osmane), dhe se tek mundësia e pranimin të autonomisë së brendshme shqiptare, duhej të gjendej gjuha e përbashkët, kjo nuk do të ndodhë me osmanizmin, si vetëdije e patriotizmit shtetëror, ku centralizmi ngrihej në kult dhe përjashtonte edhe format e qeverisjes lokale shumëshekullore që Shqiptarët kishin gëzuar gjatë gjithë kohës me çka ata kishin ruajtur identitetin etnik, gjë që kjo ua kishte krijuar edhe bindjen se ombrella perandorake i mbronte dhe i forconte njëherësh, që për pasojë do të ketë edhe besnikërinë ndaj saj, përderisa ajo shfaqej si interes i tyre.

Kjo vlen veçmas për Vilajetin e Kosovës, ku mbrojtja e atdheut nga copëtimet, e filluar me “Lidhjen Shqiptare të Prizrenit” të vitit 1878, do të kalojë nëpër

shkallën e deklarimit të besnikërisë ndaj Perandorisë Osmane madje dhe të sheriatit si kod të saj, në mënyrë që kjo, me kërkesën për bashkimin e vilajeteve shqiptare në një, të kthehet në një vetëdije politike, siç ishte ajo e Rilindjes Kombëtare me përcaktimin se ky synim mund të sendërtohej në kuadër të Perandorisë Osmane, që të mos rrezikohej as tërësia etnike shqiptare nga copëtimet që i kanoseshin nga fqinjët, e as pluralizmi shpirtëror i krijuar në rrethanat perandorake.

Deklarimi i Shqiptarëve për besnikëri ndaj Perandorisë Osmane, nga shfaqja e Krizës Lindore, dhe veçmas pas Kongresit të Berlinit, kur trojet e tyre etnike fillojnë të bëhen pre e fqinjëve (Serbëve, Malaziasve, Grekëve dhe më vonë edhe Bullgarëve), nuk do të jetë më kartë blanko. Sepse, Shqiptarët besnikërinë ndaj Perandorisë dhe Sulltanit, deshën apo nuk deshën, në radhë të parë do të detyrohen ta kushtëzojnë me mbrojtjen e etnisë shqiptare nga copëtimet, që tashmë kishin marrë kah. Madje, edhe atëherë kur Sulltan Hamiti, në fillim të qeverisjes despotike tridhjetë e dyvjeçar me qëndrimin e tij të njohur, që Shqiptarët t'i kthejë në kështjellë të mbijetesës së Perandorisë Osmane në Europë dhe do t'i cilësojë *“lulja e islamit dhe e Kalifatit”*, ndërkohë që edhe vetë do të shpallet *“baba i Shqiptarëve”*, kushtëzimi, pra mbrojtja e trojeve shqiptare nga copëtimi dhe autonomia, do të mbetet masë e vetme e besimit ndaj Perandorisë dhe Sulltanit.

Arsyetimet se autonomia e Shqiptarëve në një vilajet të përbashkët *“rrënonte unitetin e brendshëm”* dhe *“u hapte udhë të çarave, siç e kërkonin armiqtë e saj, fqinjët e Shqiptarëve”*,<sup>1271</sup> nuk ishin bindëse e as të pranueshme, karshi lëshimeve që u bëheshin fqinjëve të tyre në dëm të trojeve të tyre si dhe kërcënimeve që u vinin prej andej.

Në prag të shfaqjes së krizës së Maqedonisë, dhe veçmas pas Marrëveshjes së Mynstergut të vitit 1903, kur praktikisht Perandorisë Osmane do t'i hiqet mbikëqyrja nga pjesët europiane, ndërkohë që zhvillimet çonin kah copëtimi i mëtutjeshëm i trojeve shqiptare, besimi ndaj Sulltanit dhe mundësisë që Perandoria t'i mbronte kishte filluar t'i lëshonte edhe fanatikët e tij më të mëdhenj, të cilët kishin filluar të kërkonin mbështetje tek lëvizja opozitare e Turqve të Rinj, edhe pse ata kërkonin heqjen e despotizmit të Sulltanit dhe kthimin e kushtetutës, që ata po ashtu e shihnin të rrezikshme, nga shkakut se parlamentarizmi kthente shtetin laik, i cili, sipas tyre, rrënonte themelet e Perandorisë Osmane. Kështu që, deklarata e Xhonturqve në kongresin e Parisit rreth ruajtës së Sulltanatit dhe të Kalifatit bashkë me mbrojtjen e Perandorisë Osmane nga kërcënimet rrënuese që i vinin nga

---

<sup>1271</sup> Shih letrën Abedin Pashës drejtuar Shqiptarëve në vitin 1880 te Buxhovi, Jusuf: *“Kongresi i Berlinit 1878”*, Prishtinë, 2008, faqe 83-85.

jashtë, do të jetë faktor i rëndësishëm mbase edhe vendimtar që pjesën fanatike të Shqiptarëve, të shumtën nga radhët e feudalëve besnikë të sulltanit, të privilegjuar nga Kriza Lindore e tutje, jo vetëm ta qetësojë, por edhe ta kthejë kah lëvizja opozitare e Turqve të Rinj dhe rruga e tyre e nisur. Meqë ata tashmë i kishin shpallur luftë ndërhyrjeve të Fuqive të Mëdha, lëshimeve që u bëheshin të krishterëve në dëm të myslimanëve dhe mbrojtjes së Perandorisë Osmane nga shembja për të cilat përgjegjësinë e mbante pikërisht Sulltan Hamiti dhe qeverisja despotike e tij, e cila duhej të përmysej pse kishte kapitulluar para europianëve dhe veçmas para kërkesave të Rusisë, që mbronte vendet sllavo-ortodokse të Ballkanit.

Kjo kthese sigurisht se nuk do të ishte e mundur pa përcaktimin e hapur të bektashinjve në anën e opozitës Xhonturke dhe mbështetjes së madhe që ky tarikat, i cili përfshinte pjesën më të madhe të Jugut të Shqipërisë (Toskërinë), një pjesë të Kosovës dhe të Shqipërisë së Mesme, do t'ia japë në një anë shqiptarizmit dhe në tjetrën anë Revolucionit.

Edhe pse në vilajetin e Kosovës, shumica *sunite* dhe pakica *shiite* që nga dekreti i njohur i Sulltan Mahmuti II kundër jeniçerëve i vitit 1826 dukej se ishin në një "gjendjeje lufte" dhe se bektashinjtë kishin gjetur rastin e përshtatshëm për një hakmarrje që mund të dukej se kthente tek lufta e Qerbelasë dhe të ngjashme, megjithatë rreziku sllavo-ortodoks që tashmë me krizën e Maqedonisë kishte filluar ta tregojë gjithë fuqinë e vet rrënuese ndaj Shqiptarëve, dashur a pa dashur, *sunitet* duhej të pranonin se ishin bektashinjtë ata që në çështjen me qenë ose mos me qenë të Shqiptarët kishin marrë bajrakun mbrojtës pikërisht pse gjendeshin në anën e shqiptarizmit dhe të osmanizmit. Ky pozicionim, me të drejtë, atyre do t'ua hapë mundësinë e një trajtimi të "islamit të ndryshëm"<sup>1272</sup> jo vetëm tek Shqiptarët, por në përgjithësi edhe te popujt e tjerë europianë të pjesës së Perandorisë Osmane, gjë që sipas tyre shtonte gjasat që Perandorisë Osmane t'i zgjatej jeta në pjesën europiane në saje të këtij përcaktimi.

Hapja e kësaj çështje, gjithsesi kthen te roli i bektashinjve në zhvillimin e nacionalizmit shqiptar, i cili nuk ishte as i rastit e as jashtë konteksteve shoqërore, kulturore dhe së fundit atyre politike, të cilat do t'u shërbejnë konstrukteve të ndryshme rreth Shqipërisë Osmane, një shteti me lidhje të dyfishta, që do të mund të qëndronte si urë midis Lindjes dhe Perëndimit jo vetëm politikisht por edhe shpirtërisht.

Për t'u shpjeguar si duhet, ky kundrim, kthen edhe tek proceset shoqërore dhe rrethanat historike, që bektashizmin do ta nxjerrin në pah si faktor i rëndësishëm, i

---

<sup>1272</sup>Më gjerësisht shih Dora d'Istria "Kombësia shqiptare sipas këngëve popullore", botuar në "Revue des deux mondes", Cosenza, 1886.

cili lidhet jo vetëm me fuqinë e Perandorisë Osmane dhe të arritjes së kulmeve të saj, por edhe me depërtimin dhe pranimin e islamit në pjesët europiane, veçmas tek Shqiptarët. Sepse, siç dihej, roli i bektashinjve ishte shumë i madh si nga aspekti ushtarak - meqë mbi të mbështetej rendi i jeniçerëve si elitë perandorake, me të cilin ishin ballafaquar Shqiptarët që nga koha e *devshirmës* (haraçit të gjakut) dhe nga ai shpirtëror - si një sekt me natyrë liberale dhe humaniste brenda islamit, i cili ishte i pranueshëm për Shqiptarët.

Meqë ngritja e Shqiptarëve në strukturën ushtarake dhe atë administrative në Perandorinë Osmane ishte e lidhur ngushtë me rendin jeniçer, po ashtu edhe përqafimi i islamit nga një pjesë e madhe e tyre, kishte të bënte me bektashizmin dhe natyrën e tij liberale, që pajtonte islamin me misticizmin lindor, por në disa aspekte edhe me perëndimin. Nga Kriza Lindore e këndeje, kur shqiptarizmi do të shfaqet si nevojë mbrojtëse dhe si çështje identitare për t'u kthyer në mjet politik, ndërkohë që edhe Perandorisë Osmane, reformat nga jashtë, veçmas ato në fushën e gjyqësisë dhe të ekonomisë, do t'ia imponojnë nevojën që islamizmi t'ia lëshojë vendin osmanizmit, do të jetë bektashizmi ai që Shqiptarëve do t'u mundësojë që të largohen nga fanatizmi islamist, ndërkohë që opozitës osmane, ku merrnin pjesë edhe shumë nga Shqiptarët, veçmas pjesa intelektuale, do t'ia japë shtysën kryesore në luftë kundër despotizmit për ta rikthyer parlamentarizmin kushtetues.

Pikëtakimet e bektashizmit me nacionalizmin shqiptar si dhe ato të Turqve të Rinj ishin fryt i vetë karakterit të këtij sektit, i cili në aspektin shoqëror, kulturor dhe atë politik, pranonte ndryshimet, të menduarit ndryshe deri tek ndërlihdja e të kundërtave dhe pajtimi i tyre. Ndërsa *sunizmi*, ishte kthyer në sinonim të fanatizmit dhe të despotizmit.<sup>1273</sup> Kur bektashinjtë do të vihen në shënjestër të Sulltanatit si përkrahës të urdhrit të jeniçerëve dhe ndaj tyre do të fillojë një fushatë e egër, ajo që ndërmori Sulltan Mahmuti II, në vitin 1826, dhe do të ndalen dhe do t'u shkatërron teqetë<sup>1274</sup>, në të vërtetë Perandoria Osmane, po përgatitej për të hyrë në një

---

<sup>1273</sup> Më gjerësisht rreth rolit të bektashizmit në jetën perandorake, por edhe te nacionalizmi shqiptar shih: Frashëri, Mehdi: *“Historia e lashtë e Shqipërisë dhe e Shqiptarëve”*, Tiranë, 2012, faqe 44-49.

<sup>1274</sup> Rreth numrit të viktimave në masakrat që Sulltan Mahmuti II bëri me rastin e shtypjes së jeniçerëve dhe të bektashinjve ka shumë spekulime. Ato sillen nga disa mija deri në dyqind mijë. Disa burime meritor, duke u mbështetur në të dhënat që vijnë nga dokumente të ndryshme, zënë ngojë shifrën prej mbi 60 mijë bektashinjve, Pashallarëve, baballarëve, dervishëve si dhe myhybëve (përkrahësve) të këtij urdhri që u masakruan pamëshirshëm, që është më e përafërta. Por, krahas viktimave, urdhri i i bektashinjve do të pësojë ndjekje të vazhdueshme thujse në pjesët me të mëdha të Perandorisë me përjashtim të Shqipërisë, pjesërisht Sirisë dhe në Kurdistan, ku ata do të gjejnë strehim. Në Shqipëri, jo vetëm që do të gjejnë strehim, por edhe shtohet numri i përkrahësve të tyre. Teqetë do të mbrohen dhe do të kthehen në qendra meditimi, po edhe të përhapjes së ideve të shqiptarizmit.



fazë të re të qeverisjes despotike, e cila si parakusht kishte rrënimin e asaj që merrej “si islam i ndryshëm”, jashtë dogmës fanatike, të cilën e predikonte sunizmi.

Por, pas masakrimeve që do t’u bëhen në pjesën më të madhe të Perandorisë Osmane, bektashinjtë mbetën të paprekur në Shqipëri dhe shumë prej tyre madje në ikje e sipër nga ndjekjet e egra gjetën strehim dhe mbështetje në këtë vend, në Shqipërinë e Jugut dhe në qytetet kryesore të Kosovës (Tetovë, Prizren, Gjakovë). Ndaj, nuk ishte e rastit që rrjeti i bektashinjve, ishte njëri ndër mbështetësit kryesor të shqiptarizmit, që filloi të përdorej nga çastet e parat të Rilindjes Kombëtare nga vëllezërit Frashëri (Abdyli, Naimi dhe Samiu).

Gjithë çështja do të nisë me Abdyl Frashërin, i cili duke shfrytëzuar përkatësinë e familjes së tij tarikatit bektashi, vendosi ta përdorte këtë ndikimi në të mirë të veprimtarisë që kishte ndërmarrë përballë kërcënimit të copëtimit të territoreve nga ana e Greqisë dhe ta vinte atë në përkrahje të Shqipërisë autonome. Kështu, Abdyl Frashëri, në maj të vitit 1878, organizoi një mbledhje me parinë e Shqipërisë së Jugut në teqenë e Frashërit. Si dihet, aty do të nxirren kërkesat e para të Lëvizjes Kombëtare në një formë të hapur dhe do t’i dërgohen Portës së Lartë për shqyrtim.<sup>1275</sup>

Nëse Abdyli diti të përdorte ndikimin e baballarëve bektashinj në Jugun shqiptar, vëllezërit e tij, Samiu dhe mbi të gjitha Naimi, përdorën dhe më vonë transformuan edhe vetë ideologjinë e tarikatit për nevojat e shqiptarizmit dhe në të mirë të tij.<sup>1276</sup> Në radhë të parë për t’u liruar nga pengu i tretmanit të “*millett-osman*” me çka Shqiptarëve u hapej rruga për të shtruar kërkesën për t’u njohur si komb i pavarur në përputhje me shtrirjen e tyre etnike në truallin europian. Në vitin 1880, Samiu vinte në dukje ekzistencën në mesin e Shqiptarëve, të myslimanëve bektashi në krah të myslimanëve sunitë. Këtë e vlerësonte edhe si një argument për ta dëshmuar pluralizmin kulturor dhe atë të besimit të Shqiptarët si një veçori e rëndësishme qytetëruese.

Ngaqë bektashizmi pranonte identitetin kulturor dhe kombëtar, shtrirja e këtij tarikati të një pjesë e madhe e Shqiptarëve, paraqiste një dëshmi tjetër të njohjes së identitetit të tyre kombëtar edhe në rrethanat që islamizmi përpiqej ta mohonte në emër të identitetit fetar, i cili shihej mbi të gjitha të tjerat. Naimi, në këtë drejtim, do të shkojë edhe më larg kur doktrinën bektashiane rreth martirizimit të imamit Hysen dhe nderimit që i bëhej Abbas Aliut në malin e Tomorrit, do ta fusë në konst-

<sup>1275</sup> HHStA, PA XIV/18 Liasse XII/2 “*Memoire sur le mouvement nacional albanias*”, Bruxelles, 1899; 8-9.

<sup>1276</sup> Clayer, Natthali: “*Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*”, Tiranë, 2009, faqe 430.

ruktimin e tij të identitetit kombëtar, me shpirtin hyjnor, që aty ishte i pranishëm ngaherë, qëkur njeriu nisi të meditojë për lidhjet e tij me krijimin dhe krijuesin.<sup>1277</sup>

Me zhvillimin e ngjarjeve politike të viteve 1890, Naimi u përpoq ta transformonte bektashizmin duke futur aty sidomos dimensionin nacionalist.<sup>1278</sup> Kjo do ta bëjë edhe më të veçantë dhe më të fuqishme veprën e tij letrare, si një burim frymëzimi edhe për shtresat e gjëra, të cilat, në këtë mënyrë mund të ndikoheshin lehtë me ide kombëtare. Në *“Fletor’e Bektashinjve”*<sup>1279</sup> e botuar për herë të parë në vitin 1896, ai riformulonte doktrinën e tarikatit duke iu drejtuar jo vetëm personave, por edhe vetë bektashinjve dhe më veçanti krerëve të tyre shpirtërorë.<sup>1280</sup>

Në pjesën e fundit të tekstit, Naimi porosiste:

*“Të përpiqemi ditë e natë për atë kombë që e quajmë Atë e përgjërohet për ata, të punojnë bashkë me parësinë e me pleqësinë për shpëtimin e Shqipërisë e të shqiptarit, për dituritë e për qytetërimin e Kombit e të Mëmëdheut të tyre, për gjuhën e vetë dhe për të gjitha mborthësitë e mbarësinë, etj., etj. (...) Bashkë me pleqësinë e më parësinë, të krijojmë dashurinë e vëllazërinë, njësinë e miqësinë në mes të gjithë Shqiptarëve, të mos ndahen nga njëri tjetri, të krishterë e myslimanë të jenë tok, që të venë të gjitha punët mbroth e mbarë, të mos shahet sot shqiptari, i cili ka qenë i lavdëruar në të gjithë botën përgjithmonë.”*<sup>1281</sup>

Po ashtu, Naimi fuste një komponentë nacionaliste shqiptare në doktrinën e tarikatit pikërisht duke transformuar konceptet e dashurisë, të njohjes dhe madje edhe të ndriçimit që lidhej me *hyjnoren*. Vëllazëria dhe dashuria mistike mund të ktheheshin në vëllazëri kombëtare, përtej dallimeve fetare:

*“Në mes tyre, po edhe me gjithë njerëzit bektashinjtë janë vëllezër e shpirt”;*

*“Duan si shpirtin e tyre edhe myslimanët e tjerë dhe të krishterët”;*

*“Po më shumë duan mëmëdhenë dhe mëmëdhetarët”;*

*“Bektashinjtë e vërtetë, ç’do besë që të ketë njeriu, e kanë mbi krye dhe vëllanë e të dashurin, s’e konsiderojnë të huaj kurrë”.*<sup>1282</sup>

Në këtë rrugë Naimi ia doli që edhe poemën epike *“Qerbelaja”*,<sup>1283</sup> të frymëzuar nga *“Hadiqatu’s-su’ada”* (Kopshti i të lumturuarve) e poetit persian Fuzuli, ta

<sup>1277</sup> Po aty, faqe 431.

<sup>1278</sup> Po aty, faqe 431.

<sup>1279</sup> Ky libërth u ribotua në vitin 1908, në Sofje, më 1910, në Selanik, në 1921 në Korçë dhe në 1996 në Tiranë. U përkthye gjithashtu disa herë: pjesërisht nga Faik Konica te *Albania* (vëll.A: 174-176, 193 dhe 212-213), nga F. W. Haulsuck (në anglisht), më vonë në vitin 1920 nga H. Burgeois (në frëngjisht) dhe Norbert Jokl (në gjermanisht).

<sup>1280</sup> Birge, (John Kingsley): *“The Bektaschi Order of Dervishes”*, London, 1965.

<sup>1281</sup> Frashëri, Naim: *“Fletor’e Bektashinjet”*, 1896, faqe 14.

<sup>1282</sup> Clayer, Nathalie: *“Në fillimet e nacionalizmit shqiptar”*, Tiranë, 2009, faqe 432.

transformojë në një poemë nacionaliste, duke u bërë thirrje, në pjesën e fundit të tekstit Shqiptarëve bektashinj jo vetëm që kujtoheshin për Qerbelanë, por që gjithashtu t'i shikonin të gjithë Shqiptarët se i përkisnin të njëjtës familje dhe se, ndonëse të ndarë në besime të ndryshme fetare, ata janë një. Lutja që autori i dërgon Zotit në përfundim lidhet po ashtu me zhvillimin e një ndjenje nacionaliste dhe për arsimin e Shqiptarëve:

*“Shqiptari trim me fletë,  
si ka qenë, le të jetë,  
ta ketë gjith’ urtësinë,  
e ta dojë Shqipërinë,  
të vdesë për Mëmëdhenë,  
si Myhtari për Hysenë.”<sup>1284</sup>*

Vëllezërit Frashëri nuk ishin veprimtarët e vetëm të shqiptarizmit që përdorën dhe e transformuan bektashizmin në të mirë të shqiptarizmit. Ata gjithsesi se i hapën rrugën një të menduari ndër më të ngriturit dhe ndër më të dobishmit për çështjen shqiptare në planin shpirtëror, intelektual dhe politik në përgjithësi, që me të drejtë do të kalojë në platformë të Rilindjes Kombëtare. Pas tyre dhe duke ndjekur kornizat e shtruara prej tyre, shumë botues gazetash, që ishin të lidhur me tari-katin, bënë të njëjtën gjë duke filluar nga viti 1896-97.

Faik Konica, ishte njëri ndër ata, që dëshironte ta lidhte bektashizmin me nacionalizmin shqiptar.<sup>1285</sup>

Në vitin 1897, duke pasur tashmë revistën e tij, Konica u përpoq të ndërtonte një imazh të caktuar për bektashinjtë, si për lexuesit brenda ashtu edhe për ata jashtë. Ai merrte bektashizmin si një *skizmë islamiste* që kishte evoluar kaq shumë, saqë do të ishte më e udhës të cilësohej si një *“tërësi parimesh panteiste”* më tepër se sa një fe që kishte një kult ceremonie”.<sup>1286</sup>

Faktori bektashizëm tek Shqiptarët si pjesë e identitetit fetar që lidhet me *“islamit e ndryshëm”* dhe roli i rëndësishëm në të gjitha fazat e procesit të zgjimit kombëtar, tek perëndimorët do t'i ndihmojë si shumë krijimi të imazhit si popull me identitete të ndryshme fetare, të cilat jo vetëm që nuk e pengojnë identitetin kombëtar, por ato edhe e ndihmojnë dhe e forcojnë edhe në planin shoqëror dhe politik. Kjo, madje, do të vihet në pah edhe nga disa prej perëndimorëve, të cilët do

---

<sup>1283</sup> “*Qerbelaja*” u botua në vitin 1898.

<sup>1284</sup> Frashëri, Naim: “*Vepra*”, IV, Prishtinë, 1986, faqe 289.

<sup>1285</sup> Clyer, Nathalie: “*Në filllet e nacionalizmit shqiptar*”, Tiranë, 2009, faqe 436.

<sup>1286</sup> “*Albania*”, Bruksel, 1897, vëll. A:88

të bëjnë shumë që kjo e vërtetë të dalë në dritë për t'iu kundërvënë propagandës sllavo-ortodokse të identifikimit të plotë të Shqiptarëve me islamin fanatik si dhe me despotizmin osman ku ata paraqiten si fanatikë dhe asgjë tjetër.

Studiues, diplomatë dhe politikanë të ndryshëm do të shfrytëzojnë lidhjet e Shqiptarëve me bektashinjtë si dhe përkrahjen e tyre ndaj shqiptarizmit, që Shqiptarët politikisht t'i shohin të shkëputen nga Perandoria Osmane, ose së paku, që brenda saj, t'u jepej vendi që korrespondonte me autonominë politike dhe pranimin e tyre si komb i pavarur, pa përjashtuar këtu edhe projektin e asaj që do të quhet *Shqipëri Osmane*, që një ditë do t'ia hapte rrugën shtetit të pavarur shqiptar.

Konsulli austro-hungarez në Shkodër, Ippen, i cili ishte njëri ndër njohësit e mirë të Shqiptarëve dhe problematikës së tyre, Vjenës do t'i sugjerojë një qëndrim përkrahës ndaj bektashinjve, sepse “*bektashinjtë si liberalë pranojnë krishterimin dhe janë të gatshëm që me ta të kenë marrëdhënie të mira*”.<sup>1287</sup>

Kjo mënyrë e të parit të bektashizmi si një “*islam liberal*” dhe tolerant, në kundërshtim me sunizmin, ishte gjithashtu edhe një mënyrë për ta bërë atë “joturk”, madje europian në mënyrë që ai të ndërlihd qytetërimet aty ku të shumtën shiheshin të papajtueshme dhe në luftë të ndërsjellë. Kjo zhvendosje hetohet tek ligjërimet e Brailsfordit,<sup>1288</sup> sipas të cilit Shqiptarët “*ishin europianë të Mesjetës*”, të mbetur në një gjendje “*të ngrirë*”, që për pasojë kishte që islami i tyre të mos ishte fanatik, si i Turqve të Azisë. Ai më tutje thoshte se pjesa më e madhe e Shqiptarëve ishin “*mys-limanë jo të ngurtë*”, si të gjitha racat indo-europiane, që kishin përqaftuar islamin”.<sup>1289</sup>

Në të vërtetë për Brailsdorfin, bektashizmi ishte një formë liberale dhe here-tike e islamit që u përshtatej europianëve, ku disa prej tyre madje edhe ndjeheshin mirë me të, sidomos me aspektet e thella mistike, të cilat u mundësonin një hyrje në të fshehtat e shpirtit. Imazhi i një islami që i shkonte për shtati europianitetit vulosej me kompatibilitetin që mendohej se ai kishte me krishterimin.<sup>1290</sup>

Vënia e bektashizmit në anën e shqiptarizmit si dhe militantizmi i një pjese të madhe të klerikëve bektashinj në shërbim të drejtpërdrejt të çështjes kombëtare në çastet më kritike, siç do të jetë rasti edhe me shumë klerikë Shqiptarë nga riti ortodoks dhe katolik, të cilët në këtë rrugë do të martirizohen, arsyeton kuptimin e

---

<sup>1287</sup> Më gjerësisht shih: Ippen, Theodor: “*Beiträge zur inneren Geschichte Albaniens im XIX Jahrhundert*”, botuar te Ludwig von Thalloczy, „*Illyrisch-Albanische Forschungen*“, vol.I, München-leipzig, Von Dunker Humbolt, 1916, faqe 342-385; Ippen, Theodor; „*Skutari und die Nordalbanische Künstenebene*“, Sarajevë, 1907.

<sup>1288</sup> Shih: Brailsford (H.N.) “*Macedonia. Its races and their future*”, Londër, Matheun&Co, 1906, f. 235-247.

<sup>1289</sup> Po aty, faqe 235-247.

<sup>1290</sup> Po aty, faqe 235-247.

metaforës rreth “*shqiptarizmit si fe të Shqiptarëve*”, që Rilindësit do ta ngrehin në platformë kombëtare, e cila me të drejtë do të mbetet motoja më e fuqishme politike dhe intelektuale me të cilën do t’i hapet rruga pavarësisë kombëtare dhe kthimit të Shqiptarëve në gjirin e qytetërimit perëndimor.

Ndërlidhja e bektashizmit me shqiptarizmin dhe ndihmesa që ky i dyti do të marrë prej tij, do të krijojë edhe kushtet e përshtatshme që Lëvizja Kombëtare Shqiptare në prag të Revolucionit Xhonturk jo vetëm që të bashkëveprojë me të, por të kthehet edhe në promotor të atij ndryshimi të madh, që do të heqë nga skena politike qeverisjen absolutiste të Sulltan Hamitit për ta rikthyer kushtetutën dhe për ta sjellë të ashtuquajturin parlamentarizëm të dytë, në mënyrë, që si u tha, Shqiptarët në këtë zhvillim historik të hyjnë në cilësinë e dyfishtë: si osmanë dhe si Shqiptarë, dihomi kjo e cila ruante formulën e ruajtjes së Perandorisë Osmane - po qe se do të përfillej, dhe të rrënimit të saj - nëse do të përjashtohej, siç do të ndodhë në të vërtetë.

Pranimi i kësaj formule për Shqiptarët ishte pjesë e një gjykimi të mençur politik, meqë ashtu hapnin rrugën që të hynin në një proces të rëndësishëm, dhe njëherësh të ruanin mundësinë që atë ta shfrytëzonin për interesat e tyre.

Në Kongresin e tyre të dytë në Paris, do të jenë Xhonturqit, që me aprovimin e deklaratës për barazi të plotë qytetarë për të gjithë shtetasit e Perandorisë, ku osmanizmi shfaqet si kornizë e re gjithëpërfshirëse e patriotizmit shtetëror, do t’ia hapin rrugën përcaktimit që Shqiptarët të gjejnë gjuhë të përbashkët me osmanizmin. Madje atë ta pranojnë si çelës mbrojtës me të cilin ndalej copëtimi i trojeve të tyre po ku fitonin mundësinë që të ktheheshin në një subjekt politik të barabartë me të tjerët. *Osmanizmi si patriotizëm shtetëror*, ashtu si shpallej nga Xhonturqit, në mesin e të cilëve kishte edhe shumë Shqiptarë në pozitat udhëheqëse të tyre, edhe pse në emër të “kombit osman”, shkrinte interesat e të tjerëve në këtë mbi-shtresim. Megjithatë, Shqiptarët në këtë lëvizje shihnin mjetin dhe jo qëllimin, praktikimin e rendit kushtetues dhe të parlamentarizmit, si mundësi që t’i realizonin aspiratat e tyre me mjete të ligjshme politike dhe në mënyrë institucionale. Ishte kjo pjesë e një vetëdije që do të thadrohet te shtresa më e madhe intelektuale e Shqiptarëve për të mbetur si orientim i tyre jo vetëm atëherë dhe në ato rrethana, por edhe më vonë dhe thuajse gjithnjë.

Bashkëveprimi me Xhonturqit dhe fuqia e tyre për të vënë në lëvizje një ndryshim të madh pa mëdyshje se paraqiste “kontratën” e parë politike më të rëndësishme të Shqiptarëve me opozitën në një proces vendimtar për të ardhmen e vendit, siç ishte ai i kthimit të konstitucionalizmit dhe parlamentarizmit në Perandorinë

Osmane. Largimi i qeverisjes absolutiste në njërën anë dhe kthimi i rendit kushtetues dhe parlamentarizmit në anën tjetër, kësaj marrëveshjeje i jepnin një dimension të veçantë, meqë Shqiptarët në të hynin si një faktor i rëndësishëm, që si do të shihet ishte në gjendje që gjërat t'i vinte në lëvizje në njërin apo në tjetrin kah. Tek e fundit, Shqiptarët kishin nevojë për parlamentarizmin më shumë se të tjerët, sepse vetëm ashtu faktorizoheshin në përputhje me fuqinë e njëmendët që posedonin në përmasat e shtrirjes etnike, e cila që nga shfaqja e krizës së Maqedonisë kishte filluar të manipulohej nga vendet fqinje, të interesuara që të rrudhej sa më shumë me anën e identifikimeve fetare dhe marifeteve të tjera.

Gjatë kohës së parlamentarizmit të parë (1876- 1878), siç dihet, Shqiptarët për herë të parë do t'i paraqesin kërkesat e tyre për autonominë shqiptare brenda Perandorisë Osmane si dhe atë për njohjen e statusit të kombësisë. Këto kërkesa nga "Lidhja Shqiptare e Prizrenit" e këndej, do të kthehen në moto të përhershme të tyre, të cilat ndonëse do të refuzohen nga Sulltan Hamiti, mbetën të pakthyeshme në planin shoqëror dhe politik dhe si të vetmet atu që do të ndikojnë që Shqipëria të mbetet Shqipëri edhe atëherë kur kërcënohej deri në asgjësim.

Ndërlidhja me një vazhdimësi historike, varej nga rrëzimi i qeverisjes absolutiste, e cila mund të bëhej në bashkëveprim me Xhonturqit si dhe nga përcaktimi për mbrojtjen e Perandorisë Osmane. Ishin këto dy çështje të ndërlidhura dhe të ndërvarura. Kjo e dyta ishte madje parakusht kryesor i këtij koncepti, sepse vetëm kjo mundësonte mbrojtje nga pretendimet e fqinjëve, që ishin gjithnjë e më të zëshme dhe tashmë si qëllime të përbashkëta shpaloseshin në formën e aleancave të ndërsjella që lidheshin midis tyre.

Në përputhje me këto zhvillime, që thuajse kishin arritur pikën e vlimit, Lëvizja Kombëtare Shqiptare duhej të kishte qëndrim të qartë ndaj Maqedonisë dhe krizës së saj, krizë kjo e sajuar nga shtetet ballkanike (Serbia, Bullgaria dhe Greqia) për nevojat e veta, siç duhej të kishte qëndrim edhe ndaj Fuqive të Mëdha dhe rolit të tyre në të. Meqë ajo tashmë kishte marrë përsipër menaxhimin e saj dhe ishte më se e qartë se nën rrogos përvijoheshin planet për ndarjen e Maqedonisë në përputhje me interesat e tyre, edhe pse flitej se ndërhyrja duhej t'i shërbente ruajtjes së saj në kuadër të Perandorisë Osmane.

Nga kjo pikëpamje, për Shqiptarët, qëndrimi ndaj Maqedonisë dhe krizës së saj ishte me interes të veçantë, sepse lidhej me vetë ekzistenca e tyre si komb dhe trajtimin si etni unike, e mbi të gjitha lidhej me fatin e shtetit të tyre, i cili jashtë Maqedonisë, për shumëçka, do të ishte jo i natyrshëm dhe jo funksional.

Dhe pikërisht pse si çështje ishte e tillë, Shqiptarët duhej të veçonin interesin e tyre në të nga ai i fqinjëve (Serbëve, Bullgarëve dhe Grekëve), të cilët ishin të interesuar që me përhapjen e kaosit në atë pjesë të realizonin planet e tyre për copëtimin e saj, ndërkohë që Shqiptarët duhej ta pengonin këtë. Kjo do të thoshte se Shqiptarët jo vetëm që nuk duhej të përfshiheshin në *modelin e kosit ballkanik* me anën e çetave e të komitëve dhe të dhunës së drejtuar nga Serbia, Bullgaria dhe Greqia, por duhej ta luftonin atë, sepse vetëm ashtu do t'i ndihmonte heqjes së qëndrimit sllavo-ortodoks se në atë pjesë nuk ka çështje shqiptare, por shumë çështje të tjera të ndërlidhura mes veti sipas një lëmshi, të cilit i duhej terapia e ndërhyrjes ndërkombëtare dhe së fundit edhe copëtimi për ta zgjidhur.

Këtu dhe te kjo çështje Shqiptarët ndërlidheshin domosdoshmërisht edhe me faktorin ndërkombëtar dhe me praninë e tij, që pas Marrëveshjes së Mynstergut të vitit 1903 e deri në vitin 1908, me imponimin e reformave në Maqedoni, kishte marrë përsipër shumëçka të sovranitetit shtetëror osman në këtë pjesë. Meqë në parim, Fuqitë e Mëdha, pa marrë parasysh si sillleshin me akterët e ndryshëm ballkanikë dhe si i orientonin dhe i shfrytëzonin ata, edhe më tutje mbronin *status quo-n*, dhe me këtë edhe integritetin territorial të Perandorisë Osmane, Shqiptarëve u mbetej që të sillleshin në përputhje me këtë qëndrim dhe madje ta mbronin atë, por njëherësh të bënin përpjekje që Fuqitë e Mëdha, veçmas ato që kishin interesa të caktuara te Shqiptarët, t'i kthenin edhe më shumë nga ky interes, në mënyrë që ai të ishte në përputhje me qëllimet përfundimtare të tyre - ato që lidheshin me zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare.

Por, si do të shihet, kjo nuk ishte punë e lehtë e as e thjeshtë, sepse në ato rrethana tepër të turbullta, interesat e Shqiptarëve kushtëzoheshin në njërën anë nga raportet e Perandorisë Osmane me Fuqitë e Mëdha dhe, në tjetrën anë, të Fuqive të Mëdha me vendet ballkanike, fqinje të Shqiptarëve (Serbisë, Bullgarisë dhe Greqisë), ku ata të shumën mbeteshin në kuadër të rivaliteteve, qofshin midis fuqive të mëdha, (Austro-Hungarisë dhe të Italisë), qofshin të shteteve ballkanike (Serbisë, Bullgarisë dhe Greqisë).

Mbetjen e Shqiptarëve në këto klishe, të cilat megjithatë, nuk do të mund të qëndronin gjatë edhe përkundër deklarimeve se të gjithë ishin për ruajtjen e *status quo-s*, më së miri do ta tregojë edhe kriza e Maqedonisë, e cila ndonëse me ndërhyrjen e Fuqive të Mëdha në të, duhej të paraqiste njëfarë "harmonie", me anën e reformave të mbahej nën mbikëqyrje ndërkombëtare, do të kulmojë dhe madje do të dështojë pikërisht kur Fuqitë e Mëdha, pas shumë e shumë zvarritjeve me Portën e Lartë rreth aprovimit të pakos së reformave financiare, të cilat ishin të lidhura me

ato të reformave juridike, morën pëlqimin nga Stambolli thuajse të imponuar nga kërcënimi i një ndërhyrjeje të përbashkët ndërkombëtare në këtë pjesë.

Arsyet pse do të sakrifikohen reformat kur pritej se ato pak a shumë ishin vënë në binarë të zbatimi, gjendeshin të marrëveshja që Austro-Hungaria kishte lidhur me Portën e Lartë për ndërtimin e hekurudhës Pazar i Ri – Mitrovicë, e cila nëpër Prishtinë e Shkup, do të lidhte Selanikun me Vjenën. Ajo pas pak do të shoqërohet edhe me një marrëveshje rreth koncesioneve që i jepeshin Gjermanisë për hekurudhën e Bagdadit. Me këtë rast, Vjena e Berlioni, në bazë të disa bisedimeve me Portën e Lartë, i ofruan asaj një konventë të fshehtë ushtarake për ta mbrojtur atë bashkarisht nga agresioni i shteteve ballkanike dhe çfarëdo ndërhyrje tjetër ushtarake.<sup>1291</sup>

Ishte ky njëri ndër projektet më të rëndësishme të Austro-Hungarisë nëpër vilajetet shqiptare, me çka hapësira shqiptare kthehej në interes ekonomik dhe politik të përmasave strategjike. Si e tillë, ajo kthehej në një pretekst ashpërsimi jo vetëm midis Fuqive të Mëdha, por edhe midis vendeve ballkanike, të cilat ishin shumë të vetëdijshme, se çfarë do të thoshte një hekurudhë, e cila do të kalonte nëpër vilajetet shqiptare dhe nëpërmes Austro-Hungarisë lidhte Europën Qendrore me atë Juglindore.

Në të vërtetë, ky projekt dhe ato që do të dalin në lëndinë gjatë viteve 1907-1908, tregojnë shumë qartë interesat e Fuqive të Mëdha në Ballkan si dhe rivalitetet midis tyre, si dhe përvijimet e tyre drejt Fuqive të Boshtit në njërën anë (Austro-Hungarisë, Gjermanisë dhe Italisë) dhe Antantës, në tjetrën anë (Anglisë dhe Francës), midis të cilave do të qëndrojë Rusia, sjellja e së cilës do të përcaktohet nga përfitimet që do t'i bëjnë njëra apo tjetra anë në garën e ndërsjellë.

Megjithatë, projekti i hekurudhës austriake nëpër vilajetet shqiptare, që paraqiste një pakt austriak-gjermano-osman dhe ishte edhe interes shqiptar, do t'u shërbejë shfaqjeve të projekteve të tjera të hekurudhave ballkanike, me anën e të cilave Fuqitë e Mëdha rivalizonin mes vete në mënyrë që hapësira etnike shqiptare të humbte rëndësinë që i parashihej nga kjo lidhje. Kështu, Rusia, pasi që do të përfundojë luftën me Japoninë, doli me një projekt për hekurudhën e Adriatikut, e cila nëpër mes Rumanisë, lidhte Rusinë me Serbinë deri në Adriatik. Për këtë mori dritën e gjelbër nga Anglia dhe nga Franca, të cilat po ashtu ishin të interesuara që

---

<sup>1291</sup> Më gjerësisht shih: "Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914" (Sammlung der diplomatischen Akten des Auswärtigen Amtes), Berlin, 1915-1927, nr.22; W.M. Carigren: "Iswoisky und Aerenthal von bosnischen anexionskrise. Russische und Österreichisch-ungarische Balkanpolitik 1906-1908", Uppsala, 1995, faqe 206.



në këtë mënyrë të pengohej depërtimi i mëtutjeshëm i Austro-Hungarisë dhe i Gjermanisë në gjithë Ballkanin dhe ndërlidhja prej andej me Lindjen e Mesme.

Natyrisht se Austro-Hungaria do të refuzojë çfarëdo mundësie të ndërtimit të një hekurudhe të tillë dhe bëri të ditur, se në përputhje me pikën 23 të Kongresit të Berlinit, Malit të Zi i lejohej një hekurudhë që mund të shkonte nga Tivari në Shkodër apo ndonjë pikët tjetër në drejtim të Shqipërisë dhe assesi në veri për në Serbi.

Pasi që Anglia pushtoi Egjiptin dhe pozita e saj u dobësua në Perandorinë Osmane, hoqi dorë nga rivaliteti i hekurudhave në Ballkan në dobi të ruajtjes së *status quo-s* nga frika se ajo mund të shpinte te një afri edhe më e madhe midis Vjenës, Berlinit dhe Perandorisë Osmane. Kështu, Londra iu kthye pakos së reformave në Maqedoni, duke bërë përpjekje që të tërheq pas edhe Rusinë.

Rusia, e cila megjithëqë në ato rrethana ndodhej në kërkim të një ekuilibri me të cilin ajo do të balanconte interesat e veta me të tjerët, krahas interesimit për planet britanike për rikthimin kah reformat në Maqedoni, nuk do të heqë dorë nga mbështetja e disa nga pretendimeve austro-hungareze në Ballkan, siç ishte aneksiimi i Bosnjës dhe Hercegovinës, me kusht që asaj t'i zgjidhej çështja e ngushticave detare në Bosfor dhe Dardanele për të cilat ajo kishte interesa të mëdha.<sup>1292</sup>

Ç'është e vërteta Rusia do t'u bashkohet planeve të Anglisë për pakon e re të reformave, që do të paraqiten pas pak në takimin e qershorit të vitit 1908, në nivelin më të lartë midis dy shteteve, në Reval të Ruisë. Por, Petërburgu ruajti lidhjet e veçanta me Vjenën dhe pranoi shtrirjen e mëtutjeshëm të ndikimit të saj në pjesën perëndimore dhe jugore të Ballkanit me kusht që t'i njihen pretendimet në Bosfor (e njohur si çështje e ngushticave) si dhe ato ndaj Serbisë dhe Malit të Zi, me të cilat, pak më vonë, do të pajtohej edhe Italia, me kusht që asaj t'i lejohej që të pushtojë Tripolin.<sup>1293</sup>

## FILLIMI I KRYENGRITJES NË RESNJE DHE PËRFUNDIMI I SAJ NË FERIZAJ ME KTHIMIN E KUSHTETUTËS

Tërheqja e Austro-Hungarisë nga reformat, që siç dihet nga zbatimi i tyre ishte përjashtuar Vilajeti i Shkodrës dhe pjesa më e madhe e Vilajetit të Kosovës,

---

<sup>1292</sup> Popović, Vasilj: "Istočno pitanje", Beograd, 1946, faqe 198.

<sup>1293</sup> Galkin, I. S: "Diplomatija evropejskih drzava v svajazi s osvoboditelnim dvizeniem narodov Evropejskoj Turcii 1905-1912", Moskva, 1960, faqe 220; Pllana, Emin: "Kosova dhe reformat në Turqi", Prishtinë, 1978, faqe 228.

ndërkohë që shumica e sanxhaqeve shqiptare brenda zonës së reformave i mbi-këqyrte Vjena, me të drejtë shtoi shqetësimin te Shqiptarët se marrëveshja anglo-ruse paraqiste një përpjekje të re për përfshirjen e gjithë hapësirës së tyre në zonën e reformave, me çka rreziku i copëtimit të trojeve shqiptare nga fqinjët bëhej gjithnjë e më i madh, ndërkohë që në të njëjtën masë frika hapej edhe për pushtimin e një pjese të trojeve shqiptare nga Austro-Hungaria, që thuhej se mund të bëhej në marrëveshje me Portën e Lartë.

Turqit e Rinj madje pajtimin e Sulltanit që Vjenës t'i jepej hekurudha që lidhte Bosnjën me Kosovën për në Selanik, e vlerësuan si fillim të shkëputjes së Turqisë Europiane nga Perandoria Osmane me anën skenarëve të Fuqive të Mëdha, që tashmë ishin hartuar dhe priteshin të sendërtoheshin. Pjesë e këtyre skenarëve, sipas Xhonturqve, ishin në njërën anë marrëveshjet e Sulltan Hamitit me Austro-Hungarezët dhe gjermanët në mënyrë që me anën e hekurudhës europiane dhe asaj të Bagdadit bashkarisht me këto vende të forconin ndikimin e tyre nga Ballkani deri Lindjen e Mesme dhe të Afërme. Dhe, në tjetrën anë, ishin ato britanike, të cilat lidheshin me kundërpërgjigjen që Londra mund t'ia jepte paktit ekonomik austro-gjerman me Perandorinë Osmane.

Vlerësohej se kjo do të bëhej me ndihmën e Rusëve, të cilët ishin në gjendje që kurdoherë satelitët e tyre në Ballkan (Serbët, Malaziasit dhe Bullgarët) t'i fusnin në lojë për interesat e veta. Kjo nënkuptonte që këtë herë ata, në mënyra të ndryshme do të thellonin krizën në rajon me çka krijoheshin mundësitë për ndërhyrje ndërkombëtare, e cila me këtë rast do të bëhej drejtpërdrejt nga britanikët, që për pasojë mund të kishte ndërhyrjen austro-hungareze dhe gjermane, me të cilën hapej rruga copëtimit të Maqedonisë.

Mbi këto dhe spekulime të shumta, që me të drejtë shqetësuan Shqiptarë, të cilët edhe ashtu ndodheshin nën tryninë e vazhdueshme të emisarëve të ndryshëm që përpiqeshin t'i bënin për vete, Xhonturqit nuk e kishin të vështirë që ata t'i tërhiqnin pas për një kryengritje qoftë edhe të armatosur kundër Sulltan Hamitit. Shkas shumë i mirë për këtë shfaqje hekurudha europiane, që u ishte dhënë austriakëve, të cilën Xhonturqit zunë ta shfrytëzojnë për të akuzuar Sulltanin se me të kishte shitur interesat e vatanit tek Austriakët dhe Gjermanët, edhe pse shikuar realisht, hekurudha europiane për Shqiptarët ishte edhe interes i tyre ekonomik dhe politik, që do të mund t'ua forconte pozitën brenda rivaliteteve ballkanike duke i kthyer në interes strategjik të Austro-Hungarisë, me çka ata shumë më lehtë do të mbroheshin nga prirjet grabitqare të vendeve fqinje.

Si do të shihet, Xhonturqit do të luajnë në kartën e frikësimit të Shqiptarëve me hekurudhat se “*mund të bëheshin pre e pushtimeve austriake-gjermane*”. Kjo do t’u shërbejë atyre që këtë ta shfrytëzojnë si shkas i mirë që t’i qasen organizimit të rrëzimit të Sulltan Hamitit edhe me anën e kryengritjeve të armatosura, në radhë të parë me ato që do të shpërthejnë në viset shqiptare, prej nga pastaj do të përhapshin edhe në pjesët tjera.

Në këtë veprim Xhonturqit do të shfrytëzojnë me mjaft perfiditet “kapitalin” antieuropian dhe në veçanti atë anti-austro-gjerman, që prej kohësh në vilajetin e Kosovës dhe atë të Shkodrës kishin mbjellë fanatikët islamistë dhe një pjesë e feudallëve shqiptarë, të ndihmuar shumë edhe nga propaganda serbe si dhe paratë e saj, që tashmë nëpërmes agjentëve të shumtë të shpërndarë nëpër Kosovë, kishin filluar të derdheshin në xhepat e një pjese të parisë së vendit dhe te disa feudalë Shqiptarë, besnikë të Sulltan Hamitit. Meqë disa komitete Xhonturke tashmë kishin vënë lidhje me një pjesë të komiteteve shqiptare “*Për lirinë e Shqipërisë*”, që drejtoheshin nga Komiteti i Manastirit, ishte e pritshme që Shqiptarët të hynin në këtë valle.

Rrethanat për një veprim të përbashkët u krijuan në ditët e para të korrikut të vitit 1908, kur dy oficerë të rinj dhanë thujse në të njëjtën kohë shenjën për fillimin e kryengritjes. Ahmet Njazi beu (1873-1913), një kapiten madhor (*kolagasi*), me origjinë shqiptare, sulmoi depon ushtarake në Resnje dhe bashkë me dyqind veta. Duke përfshirë këtu edhe kryetarin e bashkisë së qytetit, mori arratinë në zonat malore prej nga lëshoi një shpallje, e cila bënte thirrje për rivendosjen e kushtetutës të vitit 1876. Thuajse në të njëjtën kohë, majori Ismail Enver beu, një anëtar i Komitetit “*Bashkim dhe Përparim*” u largua në malet pranë Resnjës.<sup>1294</sup>

Të dy oficerët dhanë sinjalin e kryengritjes, siç pritej, duke luajtur në radhë të parë me kartën e frikës së huaj. Oficerë të tjerë ndoqën shembullin e tyre dhe u ngjiten kodrave dhe maleve duke formuar çetat e tyre. Njaziu do ta ketë më të lehtë të mbledhë rreth vetes Shqiptarët, sepse ai si shqiptar tashmë kishte një marrëveshje me BajoTopullin, të cilën në kujtimet e veta e përshkruan “*shëf i komitetit toskë të Shqiptarëve*”.<sup>1295</sup>

Marrëveshja e kolonel Njaziut me BajoTopullin dhe në përgjithësi me çetat shqiptare, të përfshira në kryengritje, që të shumtën ishin të ndërlydhura me ato bullgare, do të arrihet kohë më parë në saje të ndërhyrjes së Baba Hysenit, kreu i teqesë bektashiane të Melmepanit, në krahinën e Korçës, pasi që Topulli ta ketë

<sup>1294</sup> Gawrych, George: “*Gjysmëhëna dhe shqiponja*”, Tiranë, 2007, faqe 228.

<sup>1295</sup> Shih kujtimet e Ahmet Njaziut “*Balkanlarda bir gerillaci*”, Stamboll, 1975 dhe Prifti, Kristaq: “*Doktor Ibrahim Temo – jeta dhe vepra 1865-1945*”, Prishtinë, 1996.

parë se mënyra klandestine (ilegale) e luftës me anën e çetave nuk e ndihmonte çështjen shqiptare siç mendohej fillimisht por e kthente në pre të kundërshtarëve të saj kryesor Serbëve dhe Bullgarëve, të cilëve, u duhej më shumë se kurrë përfshirja e Shqiptarëve nëpër çetat revolucionare. Baba Hyseni, në përputhje me qëndrimin e njohur të bektashinjve që të ndihmonin Xhonturqit por që kjo të bëhej në kuadër të një bashkimi të tyre për të rrëzuar sundimin absolut të Sulltan Hamitit, do të ndikojë që të gjendet gjuha e përbashkët midis komitëve Shqiptarë dhe Xhonturqve, me çka një pjesë e mirë e tyre do të shkëputen nga ndikimi i çetave bullgare dhe atyre greke si dhe nga koncepti i njohur i vendeve sllavo-ortodokse i dhunës revolucionare në shërbim të kaosit, që ndonëse për slogan kishte “luftën çlirimtare” dhe “lirinë”, nuk shkonte tutje infiltrimit në kaosin ballkanik, siç e kërkonin fqinjët e Shqiptarëve, të interesuar për t’ua shkëputur territoret.

Rebelimi i kolonel Njaziut dhe majorit Ismail Enver beu dhe fillimi i kryengritjes së tyre në rrethin e Resnjës, do të gjejë truallin e përshtatshëm për përhapje nga ngjarjet që do të pësojnë në Vilajetin e Kosovës nga mesi i qershorit, kur një pjesë e madhe e popullatës së atjeshme, do të hidhet në një kryengritje, e thirrur nga paria e vendit dhe feudalet me ndikim, pasi që të jetë përhapur lajmi për ndërtimin e hekurudhës Pazar i Ri – Mitrovicë, që pas pak do të përcillej edhe me thashethemet se ushtria e Austro-Hungarisë, gjoja pas një marrëveshje me Rusinë, ishte përgatitur që të pushtonte Kosovën.

Ç’është e vërteta, kryengritjet e përmasave më të vogla kundër ndërtimit të hekurudhës që do të lidhte Bosnjën me Kosovën me Selanikun kishin filluar qysh nga mesi i prillit në Mitrovicë, në pjesën e feudeve të Isa Boletinit, për t’u zgjeruar pak nga pak edhe në pjesët tjera, duke përfshirë këtu edhe qendrat e tjera të vilajetit, në mënyrë që përqendrimi të bëhet në Ferizaj, pasi që do të jetë hapur lajmi se Porta e Lartë kishte ndërmend t’u shiste austriakëve tokat rreth Ferizajt për ndërtimin e bazave ushtarake. Kësaj thashetheme u dha zjarr shfaqja e një njësitit të kadetëve të shkollës gjermane nga Selaniku, që ato ditë kishin ardhur për një pushim në atë pjesë, por që kjo ishte e mjaftueshme për agjentët e Xhonturqve dhe të Serbëve që kishte me bollëk atje dhe bënë të njëjtën punë, që shumë nga Shqiptarët e ndezur njëherësh nga feudalet vendorë, kleri islamik dhe propaganda e Serbisë, t’i rrokin armët dhe t’u bashkoheshin grupeve kryengritëse, siç thuhej “për ta penguar pushtimin e Kosovës nga gjermanët”.

E vetëdijshme për gjendjen serioze në të cilën ndodhej, Porta e Lartë, vendosi të merrte masa që lëvizja e Shqiptarëve të mos përhapej dhe, veçmas, të mos binte pre e Xhonturqve, të cilët pritin një rast të tillë që të vepronin. Kështu, Sulltan

Hamiti, urdhëroi gjeneralin e tij të besuar, Shemsi Pashën, të shkonte në Resnje të mbaronte punë me Najziun, Enverin dhe me oficerët tjerë të rebeluar dhe pastaj të vazhdonte për në Kosovë. Më 7 korrik, gjatë udhës për në Resnje me dy batalione trupash të rregullta, Shemsi Pasha ndaloi në qytetin e Manastirit për t'i dërguar një telegram pallatit. Ai rekomandonte që Sulltani të mobilizonte ata prijës shqiptarë, të cilëve u kishte bërë privilegje për shumë vjet me radhë, që t'u kundërviheshin oficerëve që kishin ngritur tashmë krye kundër qeverisë. Teksa doli nga zyra telegrafike dhe u drejtua për të hyrë në karrocë, një oficer i ri e qëlloi Shemsiun përpara shpurës së tij të përbërë prej truprojash shqiptare, duke e lënë atë të vdekur në vend. Humbja e tij i dha një grusht të fortë regjimit hamitian.<sup>1296</sup>

Vrasja e Shemsi Pashës si dhe propaganda që mori krye edhe më shumë solli një lëvizje të madhe të forcave të ndryshme kryengritëse kah Ferizaj, i cili nga 5 deri në 23 korrik ishte kthyer në një arenë të madhe defilimesh kryesisht refuzuese ndaj si thuhej “ndërrhyjes gjermane”, gjë që në këtë pikë propaganda e Shqiptarëve nga radhët e myslimanëve fanatikë bashkohej me atë të Xhonturqve dhe të Serbëve madje, ndonëse tejet kundërshtuese dhe shpërputhëse me njëra tjetrën për nga synimet dhe qëllimet. Por, në ato rrethana e rëndësishme ishte zhurma, pa marrë parasysh se kush do të nxirrte përfitimet dhe kush do t'i digjte gishtat.

Kështu, Shqiptarët fanatikë mbronin Sulltan Hamitin, Serbët kërkonin që të luftohej ndikimi austro-hungarez dhe gjerman dhe për këtë të bashkoheshin me këdo që në ato rrethana revolta të drejtohej kah Vjena, ndërkohë që Xhonturqit, kishin për qëllim rrëzimin e Sulltan Hamitit, pengimin e depërtimit të Austro-Hungarisë, por njëherësh për kundërshtarë kishin edhe Serbinë dhe planet e saj për copëtimin e territoreve shqiptare, ku ajo ishte fokusuar te Vilajeti i Kosovës dhe ai i Manastirit.

Për të qenë gjendja edhe më absurde, shfaqja e akterëve të ndryshëm me interesa diametralisht të kundërta, nga ato që u thanë më lartë, jo vetëm që nuk do të pengojnë që në Ferizaj të ketë demonstrim të përmasave të mëdha, ndër më të mëdhatë që ishin parë deri më atëherë në pjesën europiane të Perandorisë Osmane, por do t'i ndihmojë Revolucionit Xhonturk, që t'i realizojë qëllimet e veta, siç do të ndodhë me 24 korrik, kur Sulltan Hamiti do të shpallë dekretin për rivendosjen e kushtetutës të vitit 1876. Kjo nxirrte në pah dhe tumirte të vërtetën se nuk është fuqia e masës, ajo që përcakton kahun e ndryshimit, por aftësia e përdorimit të saj për qëllime të caktuara.

---

<sup>1296</sup> Gawrych, George: “Gjysmëhëna dhe shqiponja”, Tiranë, 2007, faqe 230.

Në Ferizaj masa kryengritëse do t'u nënshtrohet trysnive me kërkesa të ndryshme. Në një rën anë atyre të gjeneral Mahmut Shefqet Pashës, guvernator dhe komandant i Kosovës, i cili kërkonte që ajo të derdhej në përkrahje të qeverisë “*kundër ndërhyrjeve të huaja*” dhe për këtë kërkonte mbështetje tek feudalët Shqiptarë dhe paria e vendit, e cila prej kohësh gëzonte privilegjet e Sulltanit, siç ishin Isa Boletini, Bajram Curri e Sulejman agë Batusha nga Gjakova, Qerim Mahmut Begolli nga Peja, Jahja beu dhe Rasim aga nga Prizreni dhe të tjerë, të cilët edhe më tutje duhej t'i jepnin mbështetje Sulltanit që “*të mbrohej vatani nga grabitjet e fqinjëve*”. Dhe, në tjetrën anë, t'u nënshtrohej kërkesave të Mirliva Galib beut, komandant i regjimentit të xhandarmerisë së Shkupit, i cili si anëtar i Komitetit “*Bashkim dhe Përparim*”, postin e lartë zuri ta shfrytëzonte duke kërkuar përkrahje për Revolucionin. Ai u mbështet tek frika që ishte përhapur në popull për një ndërhyrje të huaj dhe ofroi si zgjidhje rivendosjen e kushtetutës pasi që qeveria kushtetuese, për ndryshim nga Sulltani i futur deri në fyt në marrëveshje me Fuqitë e Mëdha, do të pengonte pretendimet austriake dhe të tjerëve për një ndërhyrje në punët e brendshme të Perandorisë.<sup>1297</sup>

Qëndrimet e dyfishta të përfaqësuesve të shtetit osman (njërit për Sulltanin dhe tjetrit për Revolucionin Xhonturk) si dhe veprimtaria e tyre patën ndikim tek Shqiptarët, të cilët edhe ashtu ishin të ndarë në taborë të kundërta: në atë të aristokracisë - shumë prej të cilëve tashmë kishin filluar të merrnin anën e Turqve të Rinj, dhe në atë të parisë dhe feudalëve vendorë - të cilët edhe më tutje mbronin Sulltanin dhe kalifatin, por që këtë përkrahje mundoheshin ta theksonin në përputhje me rrethanat dhe klimën që krijohej. Madje disa prej tyre kërkuan që tubimi i Ferizajt, krahas gatishmërisë për mbrojtjen e vatanit nga “pushtimi austriak”, të shprehte besimin ndaj Sulltan Hamitit, një si “formulë pajtimi” për të gjithë, pa marrë parasysh vendimet përfundimtare, gjë që kështu edhe do të ndodhë.

Nexhip Draga, i cili udhëhiqte degën e Xhonturqve në Shkup mbështeste vendosjen e një qeverie kushtetuese, por nuk i pengonte që aty të ruhej edhe vendi i Sulltanit, si monark. Nga ana e tij, Isa Boletini, një nga zëvendës policët e Sulltan Hamitit në Kosovë, e barazoi qeverinë kushtetuese me pabesinë ndaj Sulltanit dhe këtij qëndrimi do t'i mbesë besnik edhe më vonë.

Megjithatë, nga mbledhja e parë e mbajtur më 15 korrik deri te ajo e fundit më 22 korrik, krerët Shqiptarë të sanxhakut të Prishtinës, të sanxhakut të Pejës, të

---

<sup>1297</sup> Gawrych, George: “*Gjysmëhëna dhe shqiponja*”, Tiranë, 2007, faqe 230.

Prizrenit dhe të krahinave veriore të Kosovës - midis të cilëve qenë Isa Boletini dhe Ferhat bej Draga nga Mitrovica, Bajram Curri e Sulejman agë Batusha nga Gjakova, Qerim Mahumt Begolli nga Peja, Jahja Beu dhe Rasim aga nga Prizreni, Mustafa Lita dhe Ramadan Zaskoku nga Luma, Fuat Pasha dhe Zenel agë Alushi nga Prishtina, Zejnullah beu dhe Abdyl Kadri efendiu nga Vushtrria, Murat Aga nga Tetova, Jakup Beu dhe Idriz Seferi nga Gjilani, si dhe Islam Pira dhe Hasan Prishtina – bënë përpjekje që të mos shkapërderdhën në anë të kundërta. Që nëse nuk bënte ndryshe, atëherë të pajtonin kushtetutën me Sulltanin dhe kjo të bëhej në emër të mbrojtjes së vatanit, si çështje e çështjeve.

Në këtë drejtim tepër veprues shfaqej Hasan Prishtina, i cili përpiquej t'i pajtonte poet shqiptare. Kështu, në tubimin e parë dhe të dytin liderët dhe feudalët shqiptarë, të cilët mundoheshin të mbanin të njëjtin bajrak, do të përqendroheshin tek çështjet e përgjithshme, pra te ato që kishin të bënin kundër ndërhyrjeve të huaja, kundër reformave që do të sillnin copëtimin e trojeve shqiptare, duke i ndërlidhur ato me masat që duhej marrë për mbrojtjen e vendit nga pushtimi i mundshëm nga jashtë, fjala ishte për atë austro-hungarez,<sup>1298</sup> edhe pse objektivisht kjo as që ekzistonte. Sepse, Sulltan Hamiti dhe në përgjithësi Porta e Lartë, kishte marrëdhënie shumë të mira me Vjenën dhe Berlinin, dhe se dhënia e koncesioneve për hekurudhën evropiane që do të kalonte nëpër viset shqiptare, ishte përcjellë edhe me një pakt të fshehtë ushtarak, me të cilin këto vende obligoheshin që të mbronin Perandorinë Osmane nga ndërhyrjet e jashtme, veçmas nga ato që mund të vinin nga vendet e Ballkanit.<sup>1299</sup>

Xhonturqit edhe pse i dinin fare mirë lidhjet e Sulltanit me Vjenën dhe Berlinin, megjithatë, dëshironin të shfrytëzonin disponimin kundër hekurudhës evropiane që ishte përhapur prej kohësh midis feudalëve shqiptarë e fanatikëve islamistë, si një mjet që do të përgatiste shkëputjen e Kosovës nga Perandoria Osmane që pastaj do të përdorej si kusuritje për nevojat e Vjenës me fqinjët e Shqiptarëve.

Në saje të kësaj propagande ndodhi që në dy mbledhjet e zgjeruara të parisë shqiptare me feudalët vendorë nuk u përmend askund kërkesa për autonominë shqiptare brenda Perandorisë Osmane, kërkesë kjo që, megjithatë, ishte shtruar nga "Lidhja Shqiptare e Prizrenit" e vitit 1878 për t'u jetësuar në vitin 1880 nga Qeveria e Përkohshme e drejtuar nga Sulejman Vokshi, që nxori Lidhja dhe në forma të ndryshme nuk ishte hequr asnjëherë nga platforma e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

<sup>1298</sup> "Historia e popullit shqiptar", vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 376.

<sup>1299</sup> Shih: "Die Grosse Politik der Europäischen Kabinette 1871-1914" (Sammlung der diplomatischen Akten des Auswärtigen Amtes, Berlin, 1915-1927, vëllimi 25, 2. faqe 870.

Në tubimin e Ferizajt ajo do të anashkalohej, jo pse interesi i vatanit në ato rrethana kërkonte vetëm mbrojtjen e tij nga rreziku i pushtimit, si thuhej, por pse autonomia shqiptare kundërshtohej nga Turqit e Rinj, njësoj siç refuzohej edhe nga Sulltan Hamiti, por këtë herë mungonte arsytimi “*se ajo rrezikonte unitetin e Perandorisë Osmane*”, që ishte zëvendësuar me parullën “*se që të gjithë shtetasit e Perandorisë, si osmanë, ishin të barabartët, të vëllazëruar dhe të lirë*” dhe se garant për këtë ishte rendi kushtetues dhe parlamentarizmi.

Kjo dhe fushata e frikësimit me gjoja rrezikun e pushtimit të vendit nga Austro-Hungaria, që ishte krijuar si dhe aktiviteti shumë i madh i Turqve të Rinj me anën e trysnisë së drejtpërdrejtë të njerëzve që drejtonin xhandarmërinë e Kosovës, siç ishte Galip Beu, komandant i xhandarmerisë së Shkupit, gjë që segmentet kryesore të shtetit: armata dhe policia bashkë me aristokratët do të marrin anën e Revolucionit, më në fund, do të ndikojnë që feudalët shqiptarë bashkë me ulemanë fanatike t’u nënshtrohen kërkesave të Xhonturqve për kthimin e kushtetutës, me kusht që atyre t’u paraprijë ajo që kishte të bënte me theksimin e besnikërisë së Sulltanit, kalifatit dhe ligjeve islamiste.

Ky formulim nuk do t’u pengojë gjithaq Turqve të Rinj, meqë ata e dinin se rikthimi i kushtetutës dhe parlamentarizmi e shpronësonte Sulltan Hamitin nga pushteti absolut siç ia hapte rrugën ardhjes në pushtet strukturave të Turqve të Rinj, që njëherësh do të thoshte përmbysje e atyre të vjetra të mbrojtura nga fanatizmi fetar. Kështu, më 20 korrik, nga tubimi i Ferizajt, Sulltanit iu dërgua një telegram, në të cilin kërkohet që të rivendosej menjëherë kushtetuta e vitit 1876 dhe të mblidhej parlamenti, me çka në Perandorinë Osmane vendosej një regjim monarkist kushtetues e parlamentar.

Pas dy ditësh, po nga Kuvendi i Ferizajt, Pallatit të sulltanit do t’i dërgohet një telegram tjetër, ku thuhej se në rast se nuk shpallej menjëherë kushtetuta:

”*Populli me armë do të zbriste drejt në Stamboll*”.<sup>1300</sup>

Gjuha e ultimatimit ishte gjuhë e Xhonturqve tashmë të përgatitur mirë për këtë ndryshim, të cilët ia dolën që Tubimin e Ferizajt ta vënë në shërbim të tyre të plotë, edhe pse krerët e Shqiptarëve në Ferizaj lidhjen e *besës* e përshkruan si një akt patriotik të kryer në mbrojtje të Sulltanit dhe të vatanit, duke theksuar se ishin të motivuar në bazë të “*besimit, fesë dhe nderit islamist*” (*din ve iman ve namus*).<sup>1301</sup>

<sup>1300</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 377.

<sup>1301</sup> Gawrych, George: “*Gjysmëhëna dhe shqiponja*”, Tiranë, 2007, faqe 232.



Madje, ata e paraqisnin kushtetutën si një dokument që garantonte “*të drejtat e shenjta të padishahut dhe sigurinë e përgjithshme të vatanit*”.<sup>1302</sup>

Me këso fjalë, që shihej se për një pjesë të mirë të tyre paraqitnin arsyetime, 194 pjesëmarrës, mes tyre edhe myftiu i Shkupit, vunë emrat nën tekstin e plotë të lidhjes së *besës*, duke u bërë të njohur si “*klerikë, sheh, aristokratë dhe prijës fisnorë të të gjithë Kosovës*”.<sup>1303</sup>

Pas arritjes në Stamboll, padyshim se telegrami i Ferizajt e tronditi dhe e zhgënjeu Sulltan Hamitin. Ferizaj i dha një grusht të rëndë politikës së tij për t’i kthyer Shqiptarët në një shtyllë mbështetje të regjimit të tij në Ballkan, të cilën ai e kishte ndjekur për tridhjetë e dy vjet me fanatizëm të madh, edhe pse kishte pasur rastin sa e sa herë të bindej nga vetë Shqiptarët se çevreja e islamizmit me të cilën ai i shihte nuk u shkonte edhe atëherë kur i shpallte “*lulja e islamit*” dhe “*lëvdata*” të ngjashme me të cilat në emër të milletit-osman u mohohej identiteti kombëtar.

Shikuar nga kjo pikëpamje Kuvendi shqiptar i Ferizajt doli se ishte një faktor më rëndësi në rivendosjen e Kushtetutës nga Sulltan Hamiti, ndërsa Shqiptarët dëshmuuan se ishin në gjendje të mbanin çelësin e kthesave të mëdha, pa marrë parasysh si dhe sa ishin të vetëdijshëm për këtë rol.

Megjithatë, rivendosja e kushtetutës së vitit 1876 dukej veprim i pashmangshëm nga ana e Sulltan Hamitit. Ka gjasa që edhe veziri i madh, shqiptari Mehmet Ferit Pasha, të kishte nxitur Sulltanin ta ndërmernte një hap të tillë, meqë kështu vendi kursehej nga një gjakderdhje e brendshme, e cila do të mund të kishte pasojë nga jashtë.

Kështu, më 23 korrik, duke u ndjerë i trishtuar prej rrjedhës që morën ngjarjet dhe duke pasur nevojë për një dash kurban, Sulltani e largoi vezirin nga posti me arsyetimin se veziri i madh shqiptar kishte dështuar në detyrën e tij për t’i mbajtur bashkëkombësit e tij besnikë ndaj Sulltanit. Në vend të tij emëroi Mehmet Said Pashën vezir të madh.

Megjithëkëtë, më 24 korrik, Sulltan Hamiti e rivendosi kushtetutën dhe me këtë i dha fund kohës tridhjetë e dy vjeçare të absolutizmit.

Këtë kohë historia nuk mund ta kalojë pa e vlerësuar si një qeverisje me dy fytyra: moderne nga jashtë dhe konservative nga brenda, ku kërkohej të pajtohej moderniteti europian (në ekonomi, ligjësi dhe në armatë) me mentalitetin shoqëror oriental dhe despotizmin, gjë që ishte e pamundur.

---

<sup>1302</sup> Po aty, faqe 233.

<sup>1303</sup> Po aty, faqe 233.

Revolucioni ia kishte arritur qëllimit duke i bashkuar të gjithë, por mbetej për t'u parë se sa ishte i sinqertë ai bashkim. Dhe, mbi të gjitha, mbetej për t'u parë, sa dhe si do t'i përmbushte premtimet e atyre që më së shumti kishin ndikuar në fitoren e tij, në rastin e dhënë të Shqiptarëve?

Dhe siç ndodh në raste të tilla, rivendosja e kushtetutës solli në fillim festime dhe eufori. Sepse qeveria kushtetuese dha fjalën për të garantuar jetën, lirinë dhe mbrojtjen e pasurisë për të gjithë shtetasit pa dallim feje dhe rase, siç i quante ajo - osmanë. Ndjenja solidariteti dhe gëzimi përshkruan Perandorinë mbarë. Xhonturqit organizuan manifestime të mëdha në thuajse të gjitha qytetet e Kosovës, por edhe në pjesët e tjera të Rumelisë.

Shpallja e kushtetutës a e Hyrjetit (*lirisë*) ngjalli një entuziazëm të madh edhe tek Shqiptarët, të cilët nuk i hiqnin nga goja parullat e përhapura në atë kohë "*liri, barazi, vëllazëri dhe drejtësi*". Vetëm disa përfaqësues konservatorë të parisë e të klerit të lartë myslimanë, të lidhur me Sulltanin dhe privilegjet e mëdha që kishin gëzuar prej tij, shpalljen e kushtetutës e pritën në mënyrë të ftohtë, me druajtje.<sup>1304</sup>

Nuk ishin vetëm Shqiptarët që kremtonin. Thirrjes së Xhonturqve për "*liri dhe barazi*" do t'u përgjigjen edhe një pjesë e mirë e popullatës sllavo-maqedonase e Vilajetit të Manastirit, të Selaniku dhe të Janinës madje edhe Serbët e Kosovës.

Xhonturqit përpiqeshin që në manifestimet e tyre të tërhiqnin që të gjithë përfaqësuesit e popujve, veçmas të krishterët, duke bërë me dije kështu, se osmanizmi ishte një formulë e cila pajtonte dhe bashkonte të gjithë shtetasit e Perandorisë Osmane pa dallim. Komiteti "*Bashkim dhe Përparim*", i cili qëndronte në ballë të të gjitha manifestimeve ndërmori hapa dhe nxori deklarata për të përcjellë imazhin e bashkimit, të përparimit dhe të vëllazërisë.

*"Të gjithë jemi të barabartë, të gjithë krenohemi që jemi osmanë"*.

Kështu thoshte majori Ismail Enver beu, ai që në Resnje do t'i bashkohet kapitenit madhor, shqiptarit Ahmet Njazi beu, kur ai filloi përhapjen e flakës së revolucionin xhonturk, e cila pastaj, me të shpejtë përfshiu gjithë Perandorinë Osmane dhe në tubimin e Ferizajt mori epilogun e duhur.

Heroi i revolucionit nxiste minoritetet fetare të futeshin në shoqëri me ç'rast një numër Grekësh, Bullgarësh dhe Serbësh u bashkuan haptas me Komitetin "*Bashkim dhe Përparim*". Në përputhje me këtë qëndrim, mbi një mijë komitë, përfshirë grekë, maqedonas, sllave dhe shqiptarë, në mënyrë simbolike i dorëzuan autoriteteve qeveritare çdo armë të panevojshme që kishin në zotim.

---

<sup>1304</sup> "*Historia e Popullit Shqiptar*", vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 377.

Jan Sandanski, udhëheqës i “*Komititetit Revolucionar Maqedonas*” (VMRO), pasi që hodhi armët, fitoi menjëherë popullaritet në publik dhe u mor në intervistë nga gazeta “*Tanin*” (Jehona), organ i KBP-së, ku ai theksoi se fitorja e revolucionit u jep-te përgjigje të drejtë çështjeve që kishin shtruar nevojën e shfaqjes së çetave dhe të luftës guerile, me çka komiti i njohur shalli të mbyllur veprimtarinë revolucionare.<sup>1305</sup>

Ngjashëm do të veprojnë edhe komitetë serbë dhe ata grekë. Kjo nuk kishte të bënte, siç thuhej nga Xhonturqit dhe propaganda e tyre, se fitorja e Revolucionit, me parullat për barazi, liri dhe vëllazërim midis kombeve të ndryshëm të Perandorisë Osmane si dhe me kthimin e kushtetutës dhe të parlamentarizmit, “*kishte bërë të panevojshme luftën e çetave*”. Por, pse kjo ishte kërkuar prej tyre nga urdhërdhënësit e njëmendët: Serbia, Bullgaria dhe Greqia, që ua mbanin penjtë atyre. Si do të shihet nga ngjarjet që do të pësojnë disa ditë më vonë (aneksimi i Bosnjës dhe Hercegovinës nga ana e Austro-Hungarisë, shpallja e pavarësisë së Bullgarisë dhe deklarimi i Kretës për t’iu bashkuar Greqisë), vendet ballkanike, që kërkonin rrëmujë në pjesën europiane të Perandorisë Osmane, së paku përkohësisht, do të heqin dorë nga destabilizimi i mëtutjeshëm i Turqisë evropiane. Kishin frikë se veprimtaria e tyre do të mund të sillte te ndonjë kthesë radikale tek Xhonturqit dhe politika e tyre ndaj Shqiptarëve, që si shenjë hakmarrjeje ndaj veprimeve austro-hungareze dhe bullgare, t’i ktheheshin ndonjë riorganizimi të ri të pjesëve të mbetura të Turqisë europiane (vilajeteve shqiptare dhe atij të Selanikut), në formë të ndonjë vetëqeverisjeje apo autonomie të Shqiptarëve në përputhje me shtrirjen e tyre etnike dhe të ngjashme. Ndërkohë edhe nxjerrja e vilajetit të Selanikut nga kontekstet e deriatëhershme maqedonase në përputhje me deklarimin e popullatës së atjeshme si sllavo-maqedonase dhe vllahë, mund ta përjashtonte Bullgarinë nga çfarëdo “e drejte” që të përzihet në punët e Maqedonisë, ani pse kjo nuk përkonte aspak me konceptin e osmanizmit mbi të cilin ata kishin ndërtuar strategjinë e ardhjes në pushtet dhe ishin betuar se do t’i rrinin besnik, siç do të ndodhë në të vërtetë.

Këtij opsioni dhe të ngjashmëve që do të mund të pasonin, do t’i frikësohet veçmas Serbia. Duke parë se Bullgarët kishin arritur një qëllim historik dhe, po ashtu, Grekët me bashkimin e njëanshëm të Kretës mund të mbeteshin të kënaqur, druanin se autonominë shqiptare në forma të ndryshme mund ta nxiste dhe ta mbështeste Austro-Hungaria (në marrëveshje me Rusinë, po qe se do t’i premtuhej kalimi i ilirë nëpër ngushticën e Bosforit dhe të Dardaneleve). Siç mund ta kërkon-te edhe Anglia, po ashtu e përkrahur nga Rusia dhe madje edhe me pëlqimin e

---

<sup>1305</sup> Gawrych, George: “*Gjysmëhëna dhe shqiponja*”, Tiranë, 2007, faqe 234.

Italisë, që t'i ndalej turri depërtimit të mëtutjeshëm të Austro-Hungarisë, që nuk përjashtonte edhe aneksimin e Shqipërisë, i cili mund të bëhej me pretekste të ndryshme, veçmas të inskenimi të ndonjë kryengritjeje, me ç'rast Vjena do të dilte fituesi kryesor.

Këto dhe hesape të ngjashme, të cilat ishin të mundshme në karuselin ballkanik, arsyetojnë qëndrimin se lëvizjet revolucionare në Maqedoni bashkë me shfaqjen e çetave dhe të komitëve, që nga fillimi ishin të instrumentalizuara nga vendet ballkanike (Serbia, Bullgaria dhe Greqia) për të krijuar gjendjen e lëmshit si parakusht të ndërhyrjes ndërkombëtare në mënyrë që asaj, në një rën anë t'i hiqej karakteri i çështjes shqiptare, siç e kishte në pjesën më të madhe, dhe t'i imponohej ajo e çështjeve të pazgjidhura të pakicave sllavo-maqedonase, që do të kthehej në shkas të copëtimit të saj.

## PËRPUTHJET DHE SHPËRPUTHJET MIDIS SHQIPTARËVE DHE XHONTURQVE

Rivendosja e kushtetutës së vitit 1876 me të drejtë zgjoi shpresat e Shqiptarëve se absolutizmi po ia lëshonte vendin një frymë të re, e cila krijonte hapësirë për ndryshime të mbara shoqërore dhe politike të një spektri të gjerë, ku liria, barazia dhe vëllazërimi hiqnin diskriminimet e njohura mbi baza fetare dhe kombëtare.

Shqiptarët osmanizmin dëshironin ta shihnin si një kornizë të përbashkët shtetërore, e plotësuar me formën e re të patriotizmit që bashkonte mbi parimet e barazisë dhe të lirisë. Shpresat se mund të ishte kështu, u bënë edhe më të dukshme pas kthimit të të mërguarve politikë dhe të të përndjekurve, që regjimi hamitan i konsideronte rebelë dhe tradhtarë dhe për vite të tëra kishin qëndruar jashtë. Shpresat u shtuan edhe më shumë kur mijëra të burgosur, të internuar nëpër pjesët e ndryshme të Perandorisë, jo vetëm që u lëshuan nga burgjet, por shumë prej tyre u amnistuan dhe madje fituan tretman të veçantë politik në radhët e komiteteve xhonturke, të cilat me të shpejtë morën rolin e shtetit në shtet në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe përkujdeseshin që t'i bënin për vete të gjitha shtresat shoqërore, sidomos ato që kishin qenë të diskriminuara apo të ndjekura gjatë kohës së qeverisjes absolutiste të Sulltan Hamitit.

Kjo klimë e ndryshimeve për të mirë u ndje edhe ndër Shqiptarët, me ç'rast përfituan, duke i fituar liritë dhe të drejtat e humbura, ata të cilët nga koha e "Lidhjes Shqiptare të Prizrenit" e këndeje, dhe veçmas pas përhapjes së zgjimit kombëtar,

kishin vuajtur pasoja të rënda ndjekjeje, burgosjesh, internimesh dhe torturash. Nga burgjet dhe internimet u liruan mbi pesë mijë Shqiptarë të Vilajetit të Kosovës dhe po aq nga ai i Manastirit dhe Janinës. Shumë prej tyre, pas internimeve të gjata, sërish morën ofiqet dhe pasurinë që u ishin marrë me rastin e dënimeve. Disa, madje edhe u dëmshpërblyen nga komitetet vendore të Xhonturqve dhe u ndërli-dhën në qeverisje vendore dhe në strukturat partiake të Turqve të Rinj.

Ndër Shqiptarët kryesorë që u kthyen në atdhe ishin Ismail Qemali, Ibrahim Temo, Devish Hima etj., të cilët fitoren e revolucionit do ta përjetojnë edhe me shqetësimin që Perandorisë Osmane në ato çaste entuziazmi, do t'i vijë nga kundër-përgjigja e jashtme, kur më 5 tetor Bullgaria deklaroi befas pavarësinë e saj nga Perandoria, ndërsa një ditë më vonë Austro-Hungaria bëri të ditur aneksimin e Bosnjë-Hercegovinës, duke i ndarë plotësisht lidhjet e saj me Stambollin, ndërko-hë që edhe Kreta, e cila deri atëherë gëzonte autonomi, deklaroi bashkimin e saj me Greqinë. Me këtë rast, asnjë nga Fuqitë e Mëdha nuk ndërmori ndonjë veprim në ndihmë të Osmanëve, duke nënvizuar në këtë mënyrë veçimin diplomatik të Perandorisë Osmane nën qeverisjen e Turqve të Rinj.<sup>1306</sup>

Kjo ishte pritur kur dihej se programi xhonturk, krahas kthimit të kushtetutës dhe parlamentarizmit, parashihte mënjanimin e ndërhyrjes së ndikimit dhe të për-zierjes së Fuqive të Mëdha në çështjet e brendshme, sidomos në ato që lidheshin me Maqedoninë dhe krizën e saj, e cila, nga ana e tyre, vlerësohej si e kurdisur dhe e instrumentalizuar për ta dobësuar ose nxjerrë fare mbikëqyrjen perandorake nga ajo pjesë në pajtim me interesat e ndryshme, që ajo pastaj të ndahej e të copëtohej.

Siç është parë edhe gjatë fushatës që do t'i paraprijë revolucionit (nga prilli deri në qershor të vitit 1908), Turqit e Rinj do të përqendrohen tek hapja e hende-kut me Austro-Hungarinë dhe Gjermaninë, vende këto me të cilat Sulltan Hamiti kishte marrëdhënie shumë të mira dhe, krahas dhënies së koncesioneve të hekurudhave (asaj europiane nëpër Sanxhak, Kosovë dhe Selanik - Vjenës dhe të atë të Bagdadit - Berlinit), ai kishte lidhur edhe një pakt të fshehtë ushtarak me to për t'u mbrojtur nga sulmet eventuale të vendeve ballkanike.

Është e njohur deklarata e ushtarakut shqiptar Ahmet Njazi beut, kur doli në mal me dyqind veta dhe në thirrjen që bënte për kryengritje theksohej *“rreziku nga pushtimi i vendit nga Austro-Hungaria”*. Ai kërkonte që të luftoheshin interesat e Vjenës në këtë pjesë dhe të shkëputeshin që të gjitha lidhjet ekonomike me të.<sup>1307</sup>

---

<sup>1306</sup> Po aty, faqe 236

<sup>1307</sup> Shih kujtimet e Ahmet Njaziut *“Balkanlarda bir gerillaci”*, Stamboll, 1975.

Aneksimi i Bosnjë-Hercegovinës më 6 tetor nga Austro-Hungaria dhe shkëputja e lidhjeve të njëanshme me Perandorinë Osmane rrënuan të gjitha lidhjet e gjata që kishte monarkia danubiane me atë të Bosforit. Andaj, nuk ishte e rastit pse krerët e lëvizjes xhonturke kërkuan edhe nga Shqiptarët që të merrnin pjesë në fushatën kundër Austro-Hungarisë. Krahas deklaramit të armiqësisë së shkallës së luftës, kërkohet edhe bojkotimi i mallrave të Vjenës, ndërprerja e të gjitha lidhjeve ekonomike dhe tregtare si dhe largimi të gjithë studentëve dhe intelektualëve që gjendeshin për studime në këtë vend.<sup>1308</sup>

Xhonturqit kishin bindjen se krahas aneksimit të Bosnjës dhe Hercegovinës, Vjena kishte dorë edhe në shpalljen e papritur të pavarësisë së Bullgarisë si dhe të deklaratës së njëanshme të Kretës për bashkim me Greqinë.

Pavarësia e Bullgarisë vlerësohet se ishte pjesë e një marrëveshjeje të fshehtë me këtë vend, që kishte për qëllim që qeverisjes xhonturke t'i bëhej me dije se vazhdimi eventual i kursit kundër Vjenës dhe interesave të saj në këtë pjesë, do ta ballafaqonte me pasoja të tjera të trysnive në pjesën europiane, ku nuk përjashtoheshin edhe masa të tjera të ngjashme.

Përballë këtyre zhvillimeve, të cilat kërkonin mbështetjen e mëtutjeshme të Shqiptarëve për rendin kushtetues dhe parlamentarizmin, të cilit ata ia kishin dhënë shtysën vendimtare në Tubimin e Ferizajt, Ismail Qemali me t'u kthyer nga mërgimi i gjatë, organizoi një peticion në Vlorë, qytetin e tij të lindjes, me anën e të cilit premtonte mbështetje për Perandorisë Osmane gjatë kësaj krize diplomatike. Zëvendës konsulli austriak, Taha në Manastir raportoi për shfaqjen si të ndjenjave patriotike osmane ashtu edhe të ndjenjave kombëtare shqiptare.<sup>1309</sup>

Burimet austriake nuk lënë për të kuptuar se Ismail Qemali kishte përdorur retorikë kundër Austro-Hungarisë, siç kërkohet prej tij nga qeveritarët e rinj. Kjo vlerësohet si qëndrim diplomatik i matur i liderit shqiptar ndaj Vjenës, meqë e dinte se ajo edhe më tutje mbetej e rëndësishme në korifeun e Fuqive të Mëdha të vendosjes.<sup>1310</sup>

Me gjithë ashpërsimet që solli Revolucioni Xhonturk në planin e jashtëm, në vilajetin e Kosovës dhe atë të Shkodrës, shpallja e kushtetutës u kuptua si shpallje e lirisë dhe e të drejtës së vetëqeverisjes së Shqipërisë. Qysh në ditët e para pas fitores së Revolucionit, në shumë qytete, si në Shkup, Prizren, Gjakovë, Pejë, Ferizaj, Kaçanik e të tjera, me nismën e komiteteve vendore, filluan të dëbohen nëpu-

---

<sup>1308</sup> Shih: Prifti, Kristaq: *"Doktor Ibrahim Temo"*, Prishtinë, 1996.

<sup>1309</sup> Gawrych, George: *"Gjysmëhëna dhe shqiponja"*, Tiranë, 2007, faqe 236.

<sup>1310</sup> Shih raportin e konsullit austro-hungarez Kral nga Manastiri drejtuar Aerenhalit, 23 nëntor 1908, nr 73, HHStA, PA XIV/15, Albanien XI/6.

nësit e aparatit të vjetër administrativ, mutesarifët, kajmekamët, gjykatësit, komandantët e xhandarmerisë dhe të policisë. Në vend të tyre emëroheshin këshilla, që përkohësisht merrnin në dorë qeverisjen vendore. U vërejt edhe fillimi i një fushate të faljes së gjaqeve.<sup>1311</sup>

Shthurja e shpejtë e administratës së vjetër osmane në Shqipëri dhe pamundësia e zëvendësimit me të rene, në disa pjesë nisi të merrte edhe përmasa të kaosit. Kjo shtyri Turqit e Rinj që në të gjitha qytetet e vendit të krijonin komitetet vendore “*Bashkim e Përparim*”, të cilat filluan të marrinë përsipër qeverisjen vendore, duke caktuar përgjegjës të përkohshëm të administratës vendore dhe të gjyqeve.

Bie në sy se komitetet e Turqve të Rinj gjatë gjithë kohës kishin parasysh interesat e Shqiptarëve dhe të shumtën bashkëpunuan ngushtë me ta në këto fusha. Kështu, në shumë qytete komitetet xhonturke më shumë shfaqnin aspiratat e popullsisë shqiptare se sa ato të Xhonturqve dhe kjo ishte e natyrshme nëse kihej parasysh se komitetet vendore kryesisht udhëhiqeshin prej Shqiptarëve dhe shfaqeshin si urë lidhëse me pushtetin e ri.

Në Vilajetin e Kosovës, për shkak të gjendjes së acaruar politike, Xhonturqit ngritën komitetet osmane “*Bashkim e Përparimi*”, vetëm në ndonjë qendër si në Shkup e në Ferizaj, ndërsa në shumicën e qyteteve të tjera formuan komisione të përziera, në të cilat merrnin pjesë përfaqësues të parisë së vendit dhe të komiteteve të Turqve të Rinj. Megjithatë, ata arritën ta kthejnë Komitetin “*Bashkim e Përparim*” të Shkupit në një organ të rëndësishëm qeveritar për gjithë vilajetin.<sup>1312</sup>

Më e rëndësishmja në këtë ndryshim ishte se edhe për Shqiptarët, si për të tjerët, ishin hapur mundësitë për organizim të lirë politik, për shtyp të lirë dhe emancipim kulturor kombëtar, me çka shkolla shqipe zinte vendin kryesor në këtë zhvillim. Përballë këtyre rrethanave pothuajse të gjitha forcat politike shqiptare u bashkuan në mendimin se Lëvizja Kombëtare duhej zhvilluar duke respektuar këtë regjim, se vepërimtaria politike dhe ajo kombëtare duhej të ishte legale në kuadër të institucioneve shtetërore dhe në parlament, ku duhej të ngriheshin që të gjitha kërkesat që kishin të bënin me barazinë dhe të drejtat tjera të cilat u takonin Shqiptarëve.

Me këtë iu dha fund organizimit të vepërimtarisë ilegale dhe formave të tjera të dhunës për qëllime politike, të cilat kishin dalë në pah nga kriza e inskenuar e Maqedonisë e këndeje, kur edhe një pjesë e Shqiptarëve, sipas shembullit të komitë-

---

<sup>1311</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 378.

<sup>1312</sup> Po aty, faqe 378.

ve serbë, bullgar dhe grek, me krijimin e çetave dhe grupeve të armatosura, kishin pranuar dhunën revolucionare dhe, me vetëdije apo pa të, luanin lojën e tyre.

Megjithatë, organizimi i lirë politik si dhe pranimi i rregullave të parlamentarizmit, shtronte nevojën e qartësisë në planin e kërkesave, të cilat duhej të ngriheshin në nivelin e programeve kombëtare që do ta gëzonin një pranim ose ujdi të përgjithshme shoqërore dhe intelektuale. Pra, shtrohej çështja rreth pozicionimit politik në rrethanat e reja të jetës parlamentare dhe të gjendjes kushtetuese me ç'rast duhej sqaruar se a duhej të vazhdohej me kërkesën për autonomi brenda Perandorisë Osmane, të dalë që nga "Lidhja Shqiptare e Prizrenit", që kjo të shtrohej në parlament dhe të mbetet çështje demokratike, apo për disa kohë ajo të lihej anash në mënyrë që të shfrytëzoheshin liritë kushtetuese për të zhvilluar në mënyrë legale lëvizjen kulturore-kombëtare, për të hapur shkolla shqipe në tërë vendin, për të përhapur me të gjitha mjetet mësimin në gjuhën shqipe dhe për lëvrimin e saj të mëtejshëm, që të shkohej më tej në ngritjen e ndërgjegjes politike të popullit për forcimin e bashkimit kombëtar të Shqiptarëve?

Kërkesa e parë, pra autonomia, sigurisht se çonte deri tek ashpërsimi i pashmangshëm me Xhonturqit, të cilët tashmë kishin përqaftuar doktrinën e osmanizmit, e shpallur në kushtetutën e vitit 1876 (neni 8) e përfshirë edhe në programin, që Komiteti Qendror "*Bashkim e Përparim*" të miratuar në mbledhjen e mbajtur në Selanik, në ditët e para të shtatorit 1908, ku edhe gjuha turke u shpall gjuhë zyrtare në administratën shtetërore dhe në shkolla.<sup>1313</sup>

Kjo megjithatë nuk përjashtonte të drejtën e Shqiptarëve që në kuadër të parlamentarizmit të shtronin edhe çështjen e statusit të ardhshëm si entitet dhe komb. Madje, edhe kushtetuta e aprovuar prej Xhonturqve, nuk ishte tabu, ngaqë mund të plotësohej ose të ndryshohej në përputhje me rrethanat dhe në rrugë *parlamentare*, siç paralajmërohej nga të gjitha anët e për të cilën ekzistonin kushte e mundësi.

Gazeta "*Kombi*", disa ditë pas shpalljes së kushtetutës shkruante se "*dëshira dhe mjete i çdo shqiptari duhet të jetë vetëqeverimi dhe shpallja e një konstitucie kombëtare, e një shteti shqiptar. Atje duhet të drejtohen të gjitha veprimet tona*".<sup>1314</sup>

Edhe kërkesa e dytë, ajo për emancipim kulturor dhe kombëtar të paktën për një periudë 10-20 vjeçare me anën e hapjes së shkollave shqipe, përkrahej nga pjesa më e madhe e popullatës, sidomos ajo e qyteteve, e cila kërkonte që të krijoheshin disa parakushte për kërkesa politike të një natyre të tillë. Gazeta

---

<sup>1313</sup> Po aty, faqe 380.

<sup>1314</sup> "*Kombi*", 31 korrik 1908.



“*Shkopi*” në këtë pikëpamje ishte fare e qartë kur bënte thirrje për hapjen e shkollave shqipe, por të kërkoheshin edhe të drejtat politike: njohja e kombit shqiptar nga qeveria osmane dhe të punonin për *vetëqeverimin* e Shqipërisë.<sup>1315</sup>

Këtë qëndrim e mbronte veçmas Mit’hat Frashëri në gazetën “*Liria*” (Selanik 1908-1910). Në shkrimet e botuar në këtë gazetë pas revolucionit, theksohej se Shqiptarët do të përmbushnin kërkesat e tyre arsimore e kulturore dhe “*do të shijonin frytet e kulturës së sotme, nëse do të hynin në komunitet me turqit*” dhe “*do të bashkëpunonin me xhemijetin (Komitetin “Bashkim e Përparim”), sepse Xhonturqit dhe Shqiptarët nuk i ndanë asgjë*”.<sup>1316</sup>

Bashkëpunimi dhe afria me Turqit, ashtu siç e preferonte Mit’hat Frashëri, me të cilën Shqiptarët fitonin mundësinë për qytetërim, megjithatë nuk ishte pa vështirësi. Sepse, si do të shihet pas pak, kërkesat e Shqiptarëve qofshin ato edhe të natyrës kulturore dhe arsimore binin ndesh me parimet e osmanizmit dhe me atë të kombit “*osmanlinj*” të shpallur nga Xhonturqit pikërisht tek emancipimi kombëtar, i cili prej tyre filloi të shikohej me dyshim dhe madje me hipotekën në ngritje e sipër se shpinte tek kërkesat separatiste.

Edhe përkundër këtyre dallimeve dhe dyshimeve, gjendja e re zuri të shfrytëzohet me të madhe për të organizuar në përmasa mbarëshqiptare lëvizjen politike kulturore, e cila do t’i shërbente edhe më tepër ngritjes së mëtejshme të ndërgjegjes kombëtare dhe për bashkimin e popullit. Për këtë qëllim, menjëherë pas Revolucionit, u ngritën klubet kombëtare që u shtrinë në qytetet e ndryshme shqiptare dhe në pjesët e tjera të Perandorisë Osmane ku kishte Shqiptarë. Bashkë me to filloi ngritja e shkollave shqipe, dhënia e mësimi të gjuhës amtare në shkollat e huaja në Shqipëri dhe u bënë përpjekje për miratimin e një alfabeti të vetëm për gjuhën shqipe.<sup>1317</sup>

Në vazhden e këtyre veprimtarive, më 31 korrik 1908, kemi themelimin e klubit të Manastirit “*Bashkimi*” me kryetar Fehmi Zavalanin, që sapo ishte liruar nga internimi, nënkryetar Gjergj Qiriazin dhe sekretar Naum Naçin. Ky klub ishte më i madh dhe më i rëndësishmi, sepse luajti një rol të veçantë në formimin e klubeve të tjera dhe në thellimin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në periudhën e regjimit Xhonturk.

Në shembullin e klubit të Manastirit dhe me nismën e atdhetarëve, u formuan në muajt gusht-shtator 1908 klubi i Korçës, i Vlorës, i Elbasanit, i Shkodrës, i Shkupit (“*Klubi arsimor shqiptar*”), i Kumanovës, i Tetovës, i Beratit, i Selanikut,

---

<sup>1315</sup> “*Shkopi*”, 15 nëntor 1908.

<sup>1316</sup> “*Liria*”, Selanik, 17 korrik, 18 gusht 1908.

<sup>1317</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 381.

i Stambollit, i Pogradecit, i Janinës dhe i Filatit. Kjo veprimtari vazhdoi edhe në periudhën e mëvonshme. Në gjithë Shqipërinë deri më atëherë u hapën më shumë se 40 klube.<sup>1318</sup>

Klubet ishin organizata të gjera demokratike, që përfshinin shtresa të ndryshme të popullsisë, por që të shumtën udhëhiqeshin nga intelektualët dhe nëpunës të aparatit shtetëror. Ato kishin statute thuajse të njëjta, në të cilat kërkohej që kombi shqiptar të gëzonte liritë që garantoheshin nga një regjim kushtetues, si dhe të drejtën e mësimit të gjuhës amtare; vihej si detyrë të punohej për bashkimin kombëtar shqiptar, për *“të ndriturit e tij duke përhapur diturinë”*, për përhapjen e arsimit në gjuhën shqipe dhe për lëvrimin e saj, për ngritjen e një kulture të popullit duke hapur shkolla, shtypshkronja dhe duke botuar gazeta e libra.<sup>1319</sup>

Ishte, pra, një frymë iluministe e zgjimit të mëtutjeshëm kombëtare në përmasa horizontale, e paparë deri më atëherë, e mbërthyer me shumë entuziazëm dhe vullnet për dije dhe kulturë, e cila duhej t’u shërbente Shqiptarëve për të arritur një nivel emancipimi, që ishte i domosdoshëm në ato rrethana. Vërehet se drejtuesit e klubeve ishin shumë të kujdesshëm që duke deklaruar *“se nuk përziheshin në çështjet politike”*, të shfrytëzonin klimën e përshtatshme shoqërore dhe politike në vend pas rikthimit të kushtetutës për çështje arsimore dhe kulturore, për shtyp të lirë dhe emancipim, i cili fund e krye ishte kombëtar, sepse klubet dhe shoqatat kishin hapur një frymë fare të re shoqërore nga e cila përfitonin të gjithë.

Në fazën e parë pas Revolucionit, Xhonturqit nuk do të pengojnë veprimtarinë e klubeve shqiptare e as që do të dalin kundër tyre. Në shumë qendra, përfaqësuesit e komiteteve xhonturke pajtoheshin me lëvizjen kulturore-arsimore të Shqiptarëve dhe atë e quanin të dobishme për forcimin e osmanizmit.

Nëse mund të thuhet se në fazën e parë, Xhonturqit nuk penguan veprimtarinë e klubeve shqiptare, në disa pjesë të vendit (Shkodër, Vlorë, Tiranë e Durrës), turkomanë vendorë dhe fanatikë nga radhët e klerit islamist, të cilët kishin humbur pushtetin që kishin gjatë kohës së sundimit absolutist të Sulltan Hamitit, bënë përpjekje që t’i pengojnë ato, ose që t’ua imponojnë frymën osmane në emër të osmanizmit. Themelimi i klubit *“Bashkimi”* në Elbasan u arrit pas një konflikti të madh të Shqiptarëve me elementet turkomanë. Ngjashëm ndodhi edhe në Vlorë me klubin *“Labëria”*. Në Shkodër turkomanët dhe paria vendore fanatike për një kohë shpërndanë klubin shqiptar të qytetit dhe arrestuan atdhetarin Dervish Hima, që

---

<sup>1318</sup> Po aty, faqe 381.

<sup>1319</sup> Po aty, faqe 381.

sapo ishte kthyer në Shkodër nga internimi, për shkak që kundërshtoi propagandën xhonturke që i shpallte Shqiptarët “osmanlinj” dhe mbrojti idenë e një Shqipërie të lirë e të pavarur.<sup>1320</sup>

Trysnia ndaj klubeve shqiptare dhe veprimtarëve atdhetarë që shqiptarizmin ta “zbusnin” paksa me osmanizmin, nuk mbetej pa pasoja. Pak nga pak, disa klube do të tërhiqen nga veprimtaria e mirëfilltë, ndërsa disa të tjera, do t’u nënshtrohen rregullave të reja të Xhonturqve, siç do të ndodhë me Klubin e Selanikut, i cili më vonë do të bjerë në thumb të kritikës të shumë atdhetarëve. Por, disa prej tyre, shpejt zunë t’u përshtaten rrethanave, që pranë klubeve legale të krijonin edhe “komitete të veçanta”, të cilat merreshin me propagandë që kishte të bënte me organizimin e fushatës për autonominë e vendit. Krijimi i komiteteve të veçanta, të cilat diku-diku shihen “të fshehta”,<sup>1321</sup> megjithatë, nuk mund të krahasohej me veprimtarinë klandestine të krijimit të çetave që ishin shfaqur me rastin e krizës së Maqedonisë, të cilat kishin përqafuar moton “e luftës çlirimtare” kundër Perandorisë Osmane, sipas modelit të njohur sllavo-ortodoks me të cilën ishin destabilizuar vilajeti i Kosovës, ai i Manastirit dhe Selanikut për interesat e Bullgarisë, Serbisë dhe të Greqisë. Përkundrazi, këtë herë, komitetet e veçanta ishin nën mbikëqyrjen e “Komitetit të Stambollit” dhe kryekreje i shërbenin intensifikimit të luftës për autonominë shqiptare përbrenda Perandorisë Osmane, me ç’rast në shërbim të saj dhe me qëllim që të kundërshtojë qeverisja centraliste xhonturke, parashiheshin protestat e hapura dhe të paralajmëruara, të cilat do të shpien deri te rebelimet dhe kryengritjet e armatosura të përmasave të mëdha siç ishin ato të viteve 1909-1912, të cilat do t’ua hapin rrugën zhvillimeve që do të çojnë te shpallja e pavarësisë së Shqipërisë.

Para se të shfaqet kjo veprimtari “e veçantë” brenda klubeve, që lidhej me çështje shoqërore dhe politike, pra në fazën e përhapjes së tyre të vullshme, klubet luajtën një rol të rëndësishëm në organizimin e Lëvizjes Kombëtare në këtë fazë të re të zhvillimit të saj. Kështu, me nismën e klubeve, për herë të parë në historinë e vendit, filluan të botohen brenda në Shqipëri edhe në disa qytete të tjera të Perandorisë Osmane gazeta në gjuhën shqipe.

Në Korçë dolën njëra pas tjetrës gazetat: “Korça” (1908-1910), nën drejtimin e Sami Pojanit; “Lidhja Ortodokse” (1909-1910) dhe “Koha” (1911-1912) nën drejtimin e Mihal Gramenos; në Manastir “Bashkimi i Kombit” (1909-1910), nga Fehmi Zavalani dhe më pas “Drita” (1911-1912), nga Mustafa Hilmi Leskoviku;

---

<sup>1320</sup> Po aty, faqe 383.

<sup>1321</sup> Po aty, faqe 383.

në Shkup “*Shkupi*” (1911-1912), nën drejtimin e Jashar Erebarës; në Janinë “*Zgimi i Shqipërisë*” (1909-1910), nga Abdyl Bakiu që u zëvendësua nga Naum Naçi; në Elbasan “*Tomori*” (1910), nga Lef Nosi dhe organe të tjera. Nga organet kryesore të shtypit shqiptar ishin gjithashtu “*Liria*” në Selanik (1908-1910), nga Mit’hat Frashëri; “*Shqipëtar*” në Stamboll (1909-1911), nga Dërvish Hima, etj.<sup>1322</sup>

Jashtë Shqipërisë vijuan të botoheshin organe të tilla të rëndësishme të shtypit shqiptar, si “*Shqypeja e Shqypënis*” (1909-1911) në Sofje; “*Shkopi*” (1907-1908) dhe “*Rrufeja*” (1909-1910) në Egjipt nën drejtimin e Josif Bagërit; “*Dielli*” (1909-1910) në Boston; “*Liri e Shqipërisë*” (1911-1915) në Sofje etj. Në vitet 1908-1912 në Shqipëri dhe jashtë botoheshin më shumë se 35 organe të shtypit shqiptar.<sup>1323</sup>

Krahas klubeve dhe gazetave shqiptare që u hapën me të shpejtë në të gjitha pjesët e Shqipërisë dhe në Stamboll e diasporë, impulse të mëdha do të marrë shkolla shqipe si dhe arsimit kombëtar, si një çështje madhore, që mundësonte identitetin kombëtar. Edhe pse kushtetuta e re pa dallim feje u njëhte të drejtën e arsimit të gjithë shtetasve të Perandorisë osmane, shpallja e tyre “osmanlinj” dhe e turqishtes si gjuhë zyrtare të detyrueshme në shkolla, mohonte të drejtën e popujve joturq për të pasur shkollat kombëtare. Në këto kushte çelja e shkollave shqipe dhe përhapja në popull e mësimin dhe e këndimit shqip, ashtu si më parë, mbetja detyrë e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, në mënyrë të veçantë e klubeve dhe i shoqërive atdhetare shqiptare.

Themelimi dhe hapja e shkollave shqipe, që një problem i vështirë, sepse pikë risht mbi atë segment do të sprovohen sfidat e bashkimit shqiptar dhe të identitetit të tyre kombëtar. Deri në vitin 1908 shkollat në Shqipëri kishin qenë të organizuara sipas linjave fetare: myslimane, ortodokse e katolike. Nëse patriotët shqiptarë donin t’i bashkonin Shqiptarët dhe të zhvillonin vetëdije e tyre kombëtare, atëherë edhe shkollat e reja duhej të ishin jofetare,<sup>1324</sup> gjë që të shumtën, kështu edhe do të ndodhë, meqë kësaj çështje tashmë i kishin dhënë përgjigjen e duhur intelektualët dhe patriotët shqiptarë Veqilharxhi, Jubani, Mitko, Kristoforidhi, vëllezërit Frashëri (Abdyli, Samiu dhe Naimi), Pashko Vasa dhe të tjerët, të cilët do ta thonë fare qartë se arsimit kombëtar duhej të mbetej jashtë sferave fetare.

Mbi këto parime hapet edhe shkolla e parë fillore shqipe më 2 gusht 1908 në Elbasan. Gjatë shatorit u hapën shkolla shqipe në Tiranë, në Berat, Gjirokastër,

---

<sup>1322</sup> Po aty, faqe 384.

<sup>1323</sup> Po aty, faqe 384.

<sup>1324</sup> Skendi, Stavro: “*Zgimi kombëtar shqiptar*”, Tiranë, faqe 334.

Korçë. Shkolla shqipe u hap edhe në Manastir, në Nistovë të Dibrës, ndërsa në Prizren vijonte të punonte shkolla shqipe e hapur më parë.

Ishte pra kjo një lëvizje e madhe, e cila zuri të përkrahej edhe nga jashtë. Kështu, ambasadori i Vjenës në Stamboll, Pavllaçini, në emër të qeverisë së tij i paraqiti zyrtarisht Portës së Lartë kërkesë për futjen e mësimit të gjuhës shqipe në të gjitha shkollat shtetërore të viseve shqiptare.<sup>1325</sup>

Kjo dhe, veçmas trysnia që Portës së Lartë do t'i vijë nga liderët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, të cilët njëherësh ishin edhe veprimtarë të lartë të Komitetit “*Bashkim dhe Përparim*”, bëri që Ministria e Arsimit, në tetor të vitit 1908, nxori urdhëresën sipas së cilës gjuha shqipe futej si lëndë mësimi në shkollat shtetërore turke, në ato fillore (*mejtepet*) dhe gjysmë të mesme (*ruzhdiye*). Në fundin e tetorit klubi “*Bashkimi*” i Janinës vendosi të fuste gjuhën shqipe në të gjitha shkollat turke dhe të themelohej në Janinë një shkollë shqipe për përgatitjen e mësuesve të gjuhës shqipe për gjithë vilajetin.<sup>1326</sup>

Gjuha shqipe zuri të futej edhe në shkollat e Kosovës. Nexhip Draga, njëri nga drejtuesit e Klubit të Shkupit, hapi disa shkolla shqipe në disa katunde të Kosovës. Duke parë këtë shtrirje, nga Prishtina dhe qytete të tjera Portës së Lartë iu nisën kërkesa dhe peticione me anën e të cilave kërkohej mësimi i gjuhës shqipe në shkollat shtetërore, sidomos në të mesmet (*idadie*), gjë që këto kërkesa u pranuan, edhe pse nga Prishtina dhe disa pjesë të tjera të Kosovës, nga forcat proturke dhe fanatike islamiste, pati kërkesa dhe protesta madje për moslejimin e tyre, me arsyetimin se çonin deri te dobësimi i lidhjeve me Perandorinë dhe kulturën islame.

Krahas futjes së gjuhës shqipe nëpër shkollat turke (fillore dhe të mesme), një sukses tjetër të madh arsimit kombëtar shënoi me hapjen e Shkollës Normale (pedagogjike) në Elbasan. Ajo filloi punimet më 1 dhjetor 1909 dhe ishte shkolla e parë e mesme kombëtare shqipe. Mësuesit e saj të parë ishin atdhetarë të njohur dhe njerëz të shquar në lëmin e kulturës, si Aleksandër Xhuvani (i diplomuar në Greqi për filologji, i dalluar në fushën e letërsisë), Sotir Peci (i diplomuar po ashtu në Greqi për matematikë-fizikë, drejtor i gazetës “Kombi”) etj. Drejtor i parë i saj u caktua Luigj Gurakuqi. Në Shkollën Normale jepnin gjithashtu mësim Pjetër Dodbiba, Simon Shuteriqi, Hasan Mejza dhe Hafiz Ibrahim Dalu.<sup>1327</sup>

<sup>1325</sup> Qarkore e besueshme e Vjenës nr. 77 e 7 tetorit 1908, HHStA, PA XIV/15, Albanien XI/6.

<sup>1326</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 389.

<sup>1327</sup> Po aty, faqe 418.

Shkolla Normale e Elbasanit qysh në vitin e parë të themelimit pati 160 nxënës të ardhur nga të gjitha anët e Shqipërisë. Disa prej tyre, rreth 50 ishin nga Kosova, Rrafshi i Dukagjinit e Dibra, të dërguar nga klubet shqiptare, si ai i Shkupit, i Dibrës e të tjerë, dhe me kujdesin e veçantë të atdhetarëve Hasan Prishtina, Bajram Curri dhe Nexhip Draga.<sup>1328</sup>

Me përpjekjet e Klubit Arsimor të Shkupit, dhe veçmas të Hasan Prishtinës e të atdhetarëve të tjerë nga Kosova, në vjeshtën e vitit 1909 u hapën shkolla shqipe në vilajetin e Kosovës, në Moravë, në Gjilan dhe në Pozharan. Në këtë kohë shkolla shqipe kanë qenë ngritur edhe në Prizren, në Gjakovë, në Pejë dhe në Vuçitërnë. Në janar të vitit 1910 klubi i Shkupit hapi një shkollë private shqipe në këtë qytet, ndërsa në shkurt u hap shkolla shqipe edhe në Mitrovicë.<sup>1329</sup>

Futja e mësimin të gjuhës shqipe si lëndë mësimi në shkollat fillore dhe ato të mesme në vilajetet shqiptare si dhe hapja e shkollave kombëtare shqipe (Normalja e Elbasanit, si dhe kërkesat e Shqiptarëve që të tilla të hapeshin edhe në pjesët e tjera dhe ato madje të financoheshin nga shteti), ngjalli kundërshtimet e fanatikëve islamistë në disa pjesë të vilajetit të Kosovës dhe atij të Shkodrës. Nga klubet e Xhonturqve si dhe ulemaja, po ku nuk mungonin edhe parafet e disa nga feudalë shqiptarë përkrahës të politikës despotike të Sulltan Hamitit, Stambollit do t'i drejtohen peticione me anën e të cilave protestohej për futjen e gjuhës shqipe në shkollat shtetërore turke si dhe në përgjithësi për hapjen e shkollave shqipe, ku thuhej se ato nuk ishin shprehje e vullnetit të myslimanëve, por të agjenturave të huaja. Në disa qytete të Kosovës si dhe në Shkodër, forcat e tilla do të organizojnë edhe protesta të hapura dhe demonstrata kundër shkollës shqipe.

Propaganda kundër shkollës shqipe dhe arsimit shqip nuk ishte as e rastit dhe as shprehje e hutisë, siç thuhej, e atyre që nuk i dallonin ndryshimet e reja. Përkundrazi, propaganda kundër gjuhës shqipe dhe shkollës shqipe kishte filluar të lidhej edhe me çështje të tjera, në mënyrë që të sillte sa më shumë shqetësime dhe me të t'i krijoheshin rrethanat e pengimit të përhapjes me arsyetimin se “refuzoeshin nga brenda”, nga ata që ndjeheshin si osmanë përpjekjet e intelektualëve dhe patriotëve shqiptarë, tashmë të përqendruara në Stamboll, ku kërkesat për emancipim kombëtar i shfaqnin haptas dhe kërkonin të përmbusheshin në kuadër të të drejtave kushtetuese që u garantoheshin, duhej të zhvisheshin sa më shumë që të ishte e mundur nga “legjitimiteti i milletit”.

---

<sup>1328</sup> Po aty, faqe 418.

<sup>1329</sup> Po aty, faqe 418.

Kësaj propagande tashmë i kishte ardhur në ndihmë kisha greke, e cila haptas kërcënonte nxënësit Shqiptarë të besimit ortodoks që kërkonin të ndalonin gjuhën shqipe me anatemin,<sup>1330</sup> gjë që e gjitha krijonte përshtypjen se dekreti për futjen e mësimit të gjuhës shqipe mund të kishte qenë i përcjellë edhe me kundërmasat dhe prapaskenat e tjera të kurdisura nga të gjitha anët, që arsimit shqip - i cili nga trysnia e Shqiptarëve si dhe të kërkesave të tyre të lidhura edhe me të drejtën kushtetuese për barazi, do të lejohej nga Perandoria Osmane - “të refuzohej” nga vetë Shqiptarët dhe të shpjegohej me atë se ata tashmë “*kishin vetëdije kulturore islamiste dhe përcaktim politik osman*”.

Do të jenë këto përçarjet e para mbi këtë bazë të cilat në vilajetin e Kosovës dhe atë të Shkodrës do të thellohen me rastin e hapjes së diskutimeve rreth alfabetit të gjuhës shqipe, të cilat do t’u shkojnë për shtati Xhonturqve që ta ndryshojnë qëndrimin ndaj përdorimit të gjuhës shqipe dhe futjes së saj nëpër shkolla me arsyetimin se “*ajo ndihmonte krijimin e vetëdijes separatiste*”.

Një vështirësi tjetër për përhapjen e shkollës shqipe, paraqitnin tekstet shkollo-re dhe alfabeti. Meqë në Shqipëri nuk kishte mundësi të botoheshin tekstet, ato filluan të vinin nga jashtë, veçmas nga Rumunia. Qysh në ditët e para pas shpalljes së kushtetutës, në fund të korrikut dhe në fillim të gushtit 1908, Shoqëria “*Bashkimi*” e Bukureshtit dërgoi në Shqipëri, përmes klubit të Manastirit, rreth 20 mijë abetare e libra të tjera shqipe. Shoqëria e Bukureshtit do të mbetet furnizuesi kryesor i shkollës shqipe me libra shqipe dhe kjo do të jetë njëra ndër ndihmesat më të mëdha që kjo shoqëri do t’i japë konsolidimit të arsimit shqip në ato rrethana. Tekstet e përmendura, megjithatë, nuk ishin të botuara me një alfabet unik, i cili mungonte. Aktualisht librat dhe tekstet shkollore do të shtypen me alfabetin e Stambollit dhe me atë të Shkodrës.

I dyti po ashtu kishte dy variante: atë të shoqërisë letrare “*Bashkimi*” dhe të asaj “*Agimi*”. Në veri ishin në përdorim alfabetet e dy shoqërive letrare, ndërsa në jug ai i Stambollit. Megjithatë, që të dy alfabetet të përbashkët kishin shkronjat latine, me huazime nga gjuhët e tjera, po me të vetmin ndryshim se alfabeti i “*Agimit*” përdorte një shkronjë për një tingull, siç kishte edhe alfabeti i Stambollit. Ndërsa ai i “*Bashkimit*” i bashkonte disa nga bashkëtingëlloret për të shënuar një tingull.

Unifikimi i alfabetit, pra, nuk ishte vetëm çështje kulturore, por për rrethanat në të cilat ndodheshin Shqiptarët, shfaqej edhe si çështje politike, me konotacione

---

<sup>1330</sup> Raporti i K. Kral drejtuar Aerenhalit nga Shkodra, më 20 janar 1909, përfshirë në dokumentet e Arkivit Shtetëror të Austrisë HHStA, PA XIV/15, Albanien XI/6.

të qarta të përballimit të dasive të tyre, të cilat pengonin bashkimin e brendshëm si dhe të fërkimeve midis qytetërimeve, të cilat aktualizoheshin për të sprovuar përkatësinë e Shqiptarëve dhe rolin e tyre që do të luajnë në procesin e shpërbërjes së Perandorisë Osmane. Meqë, përcaktimi për shkronjat latine tashmë për Shqiptarët ishte çështje e kryer dhe me anën e tij kishin krijuar parakushtet për një bashkim të brendshëm kombëtar, ku bashkoheshin Gegët dhe Toskët, siç bashkohej veriu me jugun. Ky përcaktim njëherësh paralajmëronte një fitore tjetër të rëndësishme të qytetërimit perëndimor për rikthimin e hapësirës së vet të humbur para pesë shekujsh, e cila që moti dukej e humbur, dhe për këtë humbje Serbët, Grekët dhe Rusët fajësonin Shqiptarët pse gjoja për privilegje dhe përfitime të tjera kishin kaluar në anën e Osmanëve, ku për shekuj kishin qnë madje edhe dorë e tyre e djathtë drejt nënshtrimit të rezistencës krishtere kundër tyre.<sup>1331</sup>

Patriotët Shqiptarë, brenda dhe jashtë vendit, edhe te kjo çështje e ndjeshme, ku vendosej për qenien e tyre midis Lindjes dhe Perëndimit, shfaqeshin me një përgjegjësisë të lartë. Kjo përgjegjësi historike, megjithatë, do të zë fill me themelimin e “*Shoqërisë së të shtypurit të shkronjave shqipe*” në Stamboll një vit pasi që të jetë themeluar Lidhja Shqiptare e Prizrenit.<sup>1332</sup>

Në dokumentin e saj themelor theksohej nevoja e ndriçimit të mendjeve nëpërmjet gjuhës amtare:

” *Të gjitha kombet e arsimuar kanë qenë qytetëruar me shkrime në gjuhën e tyre. Çdo komb që nuk shkruan gjuhën e vet dhe nuk ka vepra në gjuhën e tij është në errësirë dhe barbari. Dhe Shqiptarët që nuk shkruajnë gjuhën e tyre dhe që nuk kanë vepra (të tanishme) në gjuhën e tyre janë në të njëjtën gjendje...Për pasojë, ata që mendojnë dhe shohin këtë fatkeqësi të madhe janë gjithashtu të vetëdijshëm për nevojën e madhe që të shkruajnë gjuhën e tyre dhe të lexojnë vepra në të*”.<sup>1333</sup>

Vlerësime të ngjashme rreth brengës për gjuhën shqipe dhe druajtjen se pa shkrimin e saj nuk do të ketë as Shqipëri e as Shqiptarë dhe as që do të lexohet më emri Shqiptar në hartën e botës, do të thotë edhe Konstantin Kristoforidhi një vit më herët, me rastin e botimit në shqip në përkthimin e disa pjesëve nga “*Dhiata e*

---

<sup>1331</sup> Më gjerësisht rreth kësaj shih Promemorien e Kishës Ortodokse Serbe të vitit 1909, drejtuar qeverisë franceze, asaj gjermane, britanike, austro-hungareze dhe italiane rreth të ashtuquajturit “rrezikim i qytetërimit të krishterë nga shqiptaro-islamistët dhe përpjekjet e tyre për ta rrënuar krishterimin evropian”, cituar sipas Akteve të Arkivit Politik të Ministrisë së Jashtme të Gjermanisë në Bon, dokumenti nr. 13667, Tërkei, kutia 136.

<sup>1332</sup> “*Shoqëria e të Shtypurit Shkronjave Shqip*” u themelua në Stamboll më 30 shtator 1879. Në krye të saj ishte Sami Frashëri. Anëtarë të saj ishin edhe: Mehmet Ali Vrioni, Ibrahim Dino, Abdyl Frashëri, Pashko Vasa, Nikollë Banoti Shkodrani, Koto Hoxhi, Anastas Konstandin Frashëri dhe Jani Vreto Postenani.

<sup>1333</sup> Shih “*Shoqëria e Stambollit*”, botuar në “*Dituria*” II, 1926.



*Vjetër dhe e Re*”, të ndihmuar nga “*Shoqëria Biblike Britanike*”, e cila në Elbasan kishte hapur degën e vet dhe përkujdesej që liturgjia kishtare të përhapej edhe në gjuhën shqipe.<sup>1334</sup>

Ideologu i Rilindjes Kombëtare, Sami Frashëri, nuk do të trembet para vështirësive të shumta me të cilat do të përballet. Kjo shihet më së miri nga një letër që do t’ia dërgojë De Radës po ato ditë:

*“Gjuha shqipe duhet të jetë një dhe e pandarë, pikërisht ashtu siç duhet të jetë edhe Shqipëria”.*<sup>1335</sup>

Dhe kjo përgjegjësi e lartë historike do të shprehet më së miri me mbajtjen e Kongresit për alfabetin në Manastir, midis 14 dhe 22 tetorit 1908.

Para se të vijë deri te kjo ditë historike, duhet thënë se përpjekjet për gjuhën shqipe, për shkronjat shqipe dhe në përgjithësi për domosdonë e pasqyrimin të identitetit kulturor të Shqiptarëve si parakusht që i duhet atij kombëtar, do të bëhen në vitet e dyzeta të shekullit nëntëmbëdhjetë me shpalljen e reformave të Tanzimatit, me ç’rast Perandoria Osmane, së paku formalisht – por kjo kishte rëndësi – u kishte njohur kombësive të krishtera të drejtën të marrin arsimin në gjuhën amtare në shkollat publike.<sup>1336</sup>

Meqë Shqiptarëve iu mohua e drejta e shkollave të tyre nga shkakun se Porta e Lartë vazhdonte të identifikonte kombësinë me fenë, dhe kjo ishte përcaktuese edhe për statusin politik, për herë të parë shtrohej nevoja që Shqiptarëve t’u njihej e drejta e kombësisë me tri besime, por në rrugë e sipër tek kjo, atëherë të shfrytëzoheshin që të gjitha mundësitë, që Shqiptarët e krishterë të shfrytëzojnë të drejtat që ua ofronin Reformat e Tanzimatit, për të ngritur çështjen e shkollimit në gjuhën shqipe si dhe të përdorimit të gjuhës shqipe në liturgjitë fetare. Kjo ishte e nevojshme edhe më shumë, meqë hapja e arsimit fetar në Shqipëri në gjuhët e huaja (greke, serbe dhe arumune), po merrte hov dhe shtohet rreziku që ato të ktheheshin në përçarës të mëtutjeshëm të Shqiptarëve mbi përkatësi fetare. Kështu që, u shtrua nevoja që kërkesat për gjuhën dhe shkollën shqipe fillimisht të vinin prej Shqiptarëve të krishterë.<sup>1337</sup>

---

<sup>1334</sup> Më gjerësisht rreth veprimtarisë së “*Shoqërisë Biblike Britanike*” dhe përpjekjeve për futjen e gjuhës shqipe si gjuhë liturgjike kishtare shih kapitullin: “*Shqiptarët dhe qytetërimi perëndimor*”.

<sup>1335</sup> Shih pjesë të letërkëmbimit të S. Frashërit me De Radën te Skendi, Stavro: “*Zgjimi kombëtar shqiptar*”, Tiranë, 2000, faqe 117.

<sup>1336</sup> Buxhovi, Jusuf: “*Kthesa historike 3*”, Prishtinë, 2009, faqe 142.

<sup>1337</sup> Pas shpalljes së dekretit të Tanzimatit, në Shqipëri u shtua numri i shkollave greke dhe atyre serbe. Në Korçë dhe në Berat u hapen shkolla në gjuhën greke, por me gjithë programet laike, shkollat ishin nën mbikëqyrjen e peshkopëve grekë dhe përshkoheshin nga një frymë intolerante fetare dhe kombëtare.

Përpjekjet e para dhe madhore në këtë drejtim do t'i bëjë Naum Veqilharxhi (Naum Panojot Bredhi), jeta dhe vepra e të cilit, në njëfarë mënyre do të simbolizojë edhe ecuritë e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare që impulset së pari t'i vinin nga jash-të, nga pjesët e saj të shkëputura herët ose gjatë migrameve të mëvonshme. Nga Rumunia ku do të emancipohet edhe politikisht, meqë do të marrë pjesë në krye-ngritjen e madhe që shpërtheu kundër sundimit turk nën udhëheqjen e Tudor Vladimireskut dhe të A. Ypsilantit, prej andej është e njohur qarkorja që do t'ua drejtojë Shqiptarëve ortodoks, me ç'rast do të thotë:

*“Ka ardhur koha që me guxim të ndryshojmë udhë, duke marrë këtëj e tutje si kombet e përparuara në botë...”*<sup>1338</sup>

Në këtë frymë janë të njohura përpjekjet e tij për hartimin e një alfabeti të posaçëm shqip. Ai mendonte se alfabetet latin, grek ose arab, që ishin përdorur deri atëherë për shkrimin e shqipes, pa ndonjë përjashtim të veçantë, jo vetëm nuk ishin në gjendje të jepnin plotësisht të gjithë tingujt e shqipes, por asnjëri prej tyre, për arsye fetare, nuk do të pranohej nga të gjithë Shqiptarët së bashku. Duke marrë elemente nga alfabetet të mëparshme, Naumi krijoi një alfabet të ri, me të cilin hartoi disa tekste shqipe, ndër të cilat me rëndësi të madhe është *“Evetari”* (1844), një abetare e vogël, e poligrafuar, që është abetarja e parë e gjuhës shqipe. Një vit më vonë Naumi botoi një abetare të dytë *“Fare i ri evetar shqip”*, shumë më të plotë nga e para dhe të shoqëruar me parathënie të gjerë. Me këtë abetare Naumi bënte përpjekje serioze për ta venën mësimin mbi baza shkencore, u përpoq që ta pasuronte gjuhën shqipe me një varg fjalësh e termash të kulturës e të shkencës.<sup>1339</sup>

Krahas përpjekjeve të para të Naum Veqilharxhit dhe të bashkëmendimtarëve të tij nëpër vatra të veçanta në Shqipëri dhe në pjesët e tjera ku ndodhej e shpërndarë mërgata shqiptare (Rumuni, Bullgari, Egjipt dhe gjetiu), që do të çojnë te shtimi i përpjekjeve për gjuhën dhe arsimin shqip, Lëvizja Kombëtare Shqiptare, impulse të fuqishme do t'i vijnë nga përtejdeti, nga arbëreshët e Italisë. Nën ndikimin e romantizmit dhe të interesimit që shfaqte në gjysmën e parë të shekullit XIX shkenca gjuhësore europiane për gjuhën shqipe, intelektualët arbëreshë filluan të merreshin me studimin e historisë, folklorit dhe të gjuhës së tyre kombëtare, që e ruanin nga atdheu i dikurshëm.

Në kohën kur filluan të shfaqeshin idetë e para të gjuhësisë krahasuese dhe u zbuluan lidhjet gjenealogjike të një vargu gjuhës, studiuesi arbëresh, Engjëll Marashi, në vitet e para të shekullit XIX dhe Josif Krispi e Gjon Skiroi, në vitet e '30 hodhën tezën

<sup>1338</sup> Buxhovi, Jusuf: *“Kthesa historike 3”*, Prishtinë, 2009, faqe 144.

<sup>1339</sup> Po aty, faqe 144.

e prejardhjes së popullit shqiptar e të gjuhës së tij nga pellazgët dhe pellazgjishtja, gjuhë që mendohej se ishte folur nga banorët e lashtë të Ballkanit e të Mesdheut.<sup>1340</sup>

Po në këtë kohë filloi edhe veprimtaria e Jeronim De Radës nga Maki i Kalbarisë (1814-1903), i cili u bë një nga figurat më të shquara të letërsisë arbëreshe dhe të lëvizjes patriotike shqiptare në përgjithësi. Me veprat “*Këngët e Milosaos*” (1836), pastaj poemën “*Serafina Topia*” (1843), “*Skënderbeu i pafanë*”, të cilat do t’i përkthejë dhe do t’i botojë edhe në italisht, De Rada bënte të njohur lavdinë e një populli të lashtë, i cili ishte pjesë e qytetërimit të vjetër evropian, që duhej të kthehej në djepin e vet.

Përpjekje të rëndësishme për gjuhën shqipe dhe për krijimin e një alfabeti të saj, siç janë trajtuar edhe më parë kur do të fillojë qartësimi i shqiptarizmit nga islamizmi, do të shënohen pas themelimit të “*Shoqërisë së shtypjes së shkronjave shqip*” në Stamboll, në vitin 1879, kur nën drejtimin e Sami Frashërit do të krijohet një grup pune për shkronjat shqipe, me të cilat do të shtypeshin tekstet letrare dhe ato për shkollat. Me këtë alfabet, që do të quhet Alfabeti i Stambollit, do të shtypet Abetarja shqipe, e hartuar nga Sami Frashëri. Mbi këtë alfabet pastaj do të botohen edhe librat e para në Bukuresht nga shoqëria “*Drita*” si dhe veprat letrare të Naim Frashërit dhe Rilindësve të tjerë, që do të paraqesin fundamentin e Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Këto dhe vepra të ngjashme që do të botohen jashtë, bashkë me ato që Shqiptarët trashëgonin nga përkthimet e hershme të teksteve fetare, siç ishte “*Meshari*” i Buzukut nga viti 1555 dhe të relativëve të tjerë katolikë shqiptarë (Bici, Bardhi, Budi, Bogdani e të tjerë), ku vend të rëndësishëm do të zënë edhe përkthimet që do të vijnë nga Theodor Kavalioti (1770) dhe koha e Akademisë së Voskopojës, pastaj ato të Gjergj Durrësakut (1761) dhe të Dhaskal Todrit (1805), paraqitnin një pasuri shpirtërore dhe kulturore mbi të cilat mund të mbështetej alfabeti i gjuhës shqipe.

Kështu, alfabeti i gjuhës shqipe, i cili ishte i domosdoshëm dhe i kishte ardhur koha, kishte ku të kapej.

## KONGRESI I ALFABETIT NË MAMASTIR DHE SHQIPTARIZMI KULTUROR

Kongresi i alfabetit në Manastir u organizua nga klubi shqiptar i atij qyteti dhe në të morën pjesë 32 delegatë nga klubet dhe shoqëritë shqiptare, nga qytetet e shkollat si nga Shqipëria, ashtu edhe nga kolonitë përjashta si dhe 18 delegatë të tjerë si

---

<sup>1340</sup> Po aty, faqe 145.

pjesëmarrës pa të drejtë vote. Disa nga delegatë më në zë qenë: Mid'hat Frashëri, president i klubit nga Selaniku dhe botues i gazetës “*Lirija*”, Patër Gjergj Fishta, përfaqësues i “*Bashkimit*” dhe Dom Ndre Mjeda, përfaqësues i “*Agimit*” të Shkodrës, Sotir Peci, botues i gazetës “*Kombi*” në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Shahin Kolonja dhe Gjergj D. Qiriaz, Nikollë Kaçori, Hilë Mosi, Mati Logoreci, Thomas Avrami, Luigj Gurakuqi, Adem Shkaba. Aty morën pjesë edhe veprimtarë të lëvizjes kombëtare dhe të klubeve shqiptare, si Bajram e Çerçiz Topulli, Mihal Gramenojoja, Fehmi Zavalani, Dhimitër Mole, Nyzhet Vrioni, Rrok Berisha, Leonidha Naço, Dhimitraq Buda, Akil Etemi, Shefqet Frashëri, Refik Toptani, Grigor Cilika, Emin bej Shkupi, Hafiz Ibrahim efendiu (nga Shkupi), Ramiz Daci, Xhemal Beu (nga Ohri), Fahri Farshëri (nga Resnja) etj.

Kongresin e kryesoi Mid'had Frashëri, kryetar, me nënkryetarët Luigj Gurakuqi dhe Gjergj Qirazi, ndërsa dy nga delegatët që në mënyrë të veçantë ndihmuan në mirëvajtjen e punës së Kongresit dhe në arritjen e në thellimin e atmosferës së vëllazërimit dhe të pajtimit qenë Gjergj Fishta dhe Hoxhë Afiz Ibrahim, përfaqësues i Shkupit. Ky i dyti iu hodh Fishtës, kur ky la tribunën dhe e përqafoi me lot në sy. Shënohet se kjo skenë në praninë e më shumë se treqind vetave, tri të katërtat e të cilëve qenë myslimanë, s'mundi veçse të linte mbresa të thella.<sup>1341</sup>

Mbresa të mira la edhe vajtja e gjithëmbarshme e punës së Kongresit si dhe vendimet që mori. Kështu, Kongresi zgjodhi një komitet për alfabetin, i përbërë nga njëmbëdhjetë delegatë më të kulturuar, në krye me Gjergj Fishtë, të cilët për tri ditë rresht punuan rreth një qëndrimi të përbashkët dhe të dobishëm.

Nga tri propozimet, Kongresi u përqendrua te varianti i “*Bashkimit*” dhe ai i Stambollit. Më në fund, komisioni vendosi që të dy alfabetet – ai i Stambollit dhe alfabeti i ri latin - do të ishin të vetmit që do të përdreshin dhe gjithë shkollat shqipe detyroheshin t'u mësonin nxënësve të dyja.

Rezoluta mbi çështjen e alfabetit të Manastirit qe një hap i rëndësishëm drejt unifikimit të arsimit dhe të bashkimit të Shqiptarëve. Ndonëse nuk ishte një zgjidhje ideale, siç kishte për të qenë një alfabet i vetëm, qe një zgjidhje e mençur. Alfabeti i Stambollit nuk mund të flakej, sepse kishte një traditë të gjatë dhe qe përhapur gjerësisht. Megjithatë, duke eliminuar gjithë alfabetet e tjerë, vendimi i Manastirit e bënte më të lehtë komunikimin në mes të Shqiptarëve: një letër ose një libër i botuar në jug tani mund të lexohej edhe në veri dhe anasjelltas. Ai do të ndihmonte edhe për të

---

<sup>1341</sup> Skendi, Stavro: “*Zgjimi kombëtar shqiptar*”, Tiranë, 2000, faqe 337.

bërë Shqiptarët e besimit mysliman dhe ata të krishterë më të ndërgjegjshëm për trashëgiminë e tyre të përbashkët.<sup>1342</sup>

Megjithëse çështja e njësimin të alfabetit zuri vendin kryesor në punimet e Kongresit të Manastirit, vetë Kongresi nuk ishte një mbledhje thjesht gjuhësore, por edhe një manifestim politik.<sup>1343</sup> Krahas tubimeve të hapura, u organizuan edhe mbledhje të mbyllura kushtuar çështjeve politike të ditës, në të cilat u diskutua rreth marrëdhënieve të Shqiptarëve me qeverinë xhonturke si dhe lufta për të drejta kombëtare të Shqiptarëve, në të cilat përfshiheshin edhe çështjet që kishin të bënin me zhvillimin kulturor dhe ekonomik të vendit si dhe marrëdhëniet me shtetet europiane.<sup>1344</sup>

Në fund u hartuar një program kombëtar prej 18 pikash, që iu dha deputetit të Korçës, Shahin Kolonjës, për ta paraqitur në parlament në emër të Shqiptarëve. Ky program është një dokument i rëndësishëm i Kongresit të Manastirit, në të cilin u pasqyruan aspiratat e Shqiptarëve për autonominë territoriale-administrative të Shqipërisë<sup>1345</sup>, për atë që tashmë nga Shqiptarët dhe nga disa vende europiane nga radhët e Fuqive të Mëdha projektohej si Shqipëri Osmane, e cila do të paraqiste një Shqipëri etnike dhe do të mevetësohej si shtet i pavarur çastet që Perandoria Osmane do të largohej nga pjesa europiane.

Ndër pikat kryesore të programit ishin ato që lidheshin me kërkesat politike “për njohjen zyrtare të kombësisë shqiptare dhe të gjuhës shqipe”, pastaj themelimi i pavarur i shkollës shqipe, që do të arrihej duke i kthyer që të gjitha shkollat shtetërore turke në Shqipëri, ato fillore, qytetare e të mesme, në shkolla kombëtare dhe duke vendosur gjuhën amtare shqipe si gjuhë mësimi në të gjitha shkollat shtetërore, ndërsa turqishtja do të mësohej si lëndë e veçantë, duke filluar nga viti i katërt i shkollës fillore. Të lidhura ngushtë me këtë ishin edhe masat që parashikohej të merreshin për kthimin e shkollave në gjuhën greke, që funksiononin për Shqiptarët e krishterë, në shkolla kombëtare, me gjuhë shqipe si gjuhë mësimi, duke i hequr ato nga administrimi i klerit dhe duke i shpallur shkolla shtetërore.<sup>1346</sup>

Një nga kërkesat më të rëndësishme në fushën e arsimit ishte ajo për themelimin e një universiteti shqiptar, që kishte qenë aspiratë e hershme e Rilindësve.

Ndërgjegjësimi rreth të përbashkëtës dhe kapërcimi i ndasive që do të sjellë alfabeti i shqipes bashkë me shkollën shqipe dhe arsimimin ndër Shqiptarë dhe

---

<sup>1342</sup> Po aty, faqe 339.

<sup>1343</sup> “Historia e Popullit Shqiptar”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 394.

<sup>1344</sup> Po aty, faqe 394.

<sup>1345</sup> Po aty, faqe 394.

<sup>1346</sup> Po aty, faqe 395.

kthimi i saj në një faktor të ri shprehës të identitetit kombëtar në përputhje me qytetërimin perëndimor, do të jetë ajo që më së shumti do t'i shqetësojë Xhonturqit dhe pjesën fanatike osmane, të cilët e kishin më se të qartë se me Shqiptarët e zgjuar kombëtarisht nuk mund të bëheshin hesape si ato që parashihej të përdreshin për t'u ruajtur prania perandorake në pjesën europiane dhe në pjesë të madhe do të ndikojnë në rezonin politik të Xhonturqve. Kështu që nderzja e propagandës islamiste kundër alfabetit dhe gjuhës shqipe, ishte pjesë e strategjisë së tërheqjes së myslimanëve shqiptarë në anën e tyre, qoftë edhe me anën e frikësimit në masë i ngjashëm me atë të hesapit pa hanxhiun.

Të kësaj natyre qenë edhe përpjekjet kur refuzimi i alfabetit latin lidhej me “gjynahun” ndaj Kuranit dhe gjoja dallashimin e tij të plotë po qe se ai do të lexohej me shkronja latine dhe i shkruar nga e majta në të djathtë dhe jo sipas rregullave të Profetit me çka turma mund të ndizej shumë shpejt!<sup>1347</sup>

“Gjynahu” ndaj Kuranit dhe largimi nga “rregullat e Profetit” do të hapë fazën e fundit të luftës së Shqiptarëve drejt shkëputjes shpirtërore prej Perandorisë Osmane dhe kthimit nga civilizimi perëndimor, edhe pse me gjuhën politike kësaj shkëputjeje përfundimtare që do të pasojë pas pak, nga themelimi i “Lidhjes Shqiptare të Prizrenit” e këndeje, do t'i vishet petku i kërkesës për autonomi dhe barazi, që nuk paraqiste tjetër pos një strategji të dobishme drejt arritjes së pavarësisë kombëtare, gjithnjë duke pasur parasysh rrethanat dhe kohën më të përshtatshme për të si dhe pasojat që do të shkaktojë.

Me qëndrimin që gjuha shqipe të shkruhej me shkronja arabe, që pas pak do të kthehet në kërkesë zyrtare të qeverisë dhe ajo do të përcillej me fushatë të ashpër që do të përfshijë pjesën më fanatike të shoqërisë e edhe kreun më të lartë të klerit islamist, Porta e Lartë edhe më tutje do ta shtojë përkushtimin e Shqiptarëve për alfabetin me shkronja latine dhe për mbrojtjen e gjuhës dhe të shkollës shqipe. Kështu, për herë të parë tek Shqiptarët del në pah përparësia e ndjenjës kombëtare ndaj asaj fetare, të cilën pushtimi osman me imponimin e islamit kishte menduar se kahe-rë e kishte zgjidhur në dobi të myslimanizmit.

Kur jemi te kleri islamist dhe fushata e egër që do të zhvillojë në Shqipëri kundër gjuhës shqipe dhe alfabetit të saj me shkronja latine, nuk do të kursehen mjetet duke futur në lojë edhe “mbrojtjen” e Kuranit, që paralajmëronte qërimin e hesapeve me “kaurët” sipas Xhihadit dhe me mjetet e tij që dihej se çfarë ishin. Megjithatë duhet theksuar faktin se jo të gjithë klerikët shqiptarë pranuan gjuhën e ulemave të

---

<sup>1347</sup> Shih shkrimin në gazetën “Liria”, 15 nëntor 1908.

Stambollit, se jo të gjithë osmanistët, nga radhët e Shqiptarëve, mendonin se identiteti shqiptar duhej të sakrifikohej për atë islam. Përkundrazi, kishte Shqiptarë, të cilët mendonin se osmanizmi nuk duhej të binte ndesh me ndjenjën kombëtare shqiptare, por që ai të orientohej drejt ruajtjes së shtetit osman dhe të pranisë së tij në pjesën europiane, si interes i përbashkët i tyre, meqë vlerësohej se vetëm ashtu mund t'u bëhej ballë apetiteve hegjemoniste të fqinjëve dhe prirjeve pan-sllaviste, të cilat i ushqente dhe i drejtonte Rusia me aleatët e saj. Andaj, nuk ishte e rastit pse shumë nga përfaqësuesit e klerit mysliman në Shqipëri, që nga fillimi i hapjes së çështjes së gjuhës u vunë në anën e alfabetit të shqipes me shkronja të veçanta, të cilat do të ishin në përputhje me traditën historike të shkrimit shqip.

Edhe pse Porta e Lartë u mundua ta fshehtë veprimtarinë patriotike të një pjese të mirë të klerikëve myslimanë nga radhët e Shqiptarëve, ishin shumë sish që u vunë në anë e vendimeve të Kongresit të Manastirit dhe të Lëvizjes Kombëtare për Pavarësi, disa prej tyre duke u kthyer edhe në martirë të saj.

Njëri ndër ta, Hoxha Vildan Efendiu, anëtar i “Komitetit Këshillues” të Kongresit të Manastirit nga radhët e Klubit shqiptar të Stambollit, jo vetëm që do t'i kundërvihet qëndrimit zyrtar turk dhe ulemasë, por ai do të mbrojë me gjithë fuqinë vendimet e Kongresit të Manastirit. Ai do të sulmojë sundimin despotik të Sulltan Hamitit dhe do të theksojë rëndësinë e bashkimit të Shqiptarëve, sepse vetëm të bashkuar mund të mbronin vetveten por edhe Perandorinë:

*“Shqipëria tani është e lumtur, sepse është e bashkuar me anë të alfabetit, që qe një vegël e fuqishme për mbarëvajtjen e saj. Cilido komb ka të drejtë të zgjedhë alfabetin që i përshtatet gjuhës së tij. Dhe Shqiptarët zgjodhën si të tillë alfabetin latin.”<sup>1348</sup>*

Më tutje Hoxha Vildan Efendia do të thotë se edhe turqit nuk kishin pasurshkronja për të shkruar gjuhën e tyre; ata kishin adoptuar ato të Arabëve. Në këtë linjë ai foli në gjithë viset që vizitoi Komisioni i Stambollit. Theksoi se ishte gabim të mendohet se Kurani lejonte shkrimin e gjuhës shqipe veçse me shkronja arabe dhe arsyetoj se shkronjat nuk kishin origjinë hyjnore por qenë një krijim i njeriut.

*“Nuk mund të thuhej që arabishtja ishte e vetmja gjuhë që i pëlqente Perëndisë, meqë kishte edhe shumë libra fetare të shkruara në turqisht. Për pasojë, nuk kishte asnjë pengesë për të përdorur shkronjat latine për shqipen.”<sup>1349</sup>*

Qëndrimi i Hoxha Vildan Efendisë kishte rëndësi, sepse ai me Fezil Pashën dhe Kolonelin Riza, si të deleguar të “Klubit shqiptar” të Stambollit kishin ardhur me

<sup>1348</sup> Skendi, Stavro: *“Zgjidimi kombëtar shqiptar”*, Tiranë, 2000, faqe 340.

<sup>1349</sup> Raport i Kral drejtuar Aerenthalit, Shkodër, 31 dhjetor 1908, nr 166, HHSa, PA XIV/15, Albanien XI/6.

vonesë në Kongres dhe që menduar se mund të ishin aty me mision të komitetit xhonturk, i cili mund të kishte qëllime përçarëse.

Por, do të shihet se “Komiteti Këshillues”, me autorizimin e Klubit Shqiptar të Stambollit, do të merreshin me punë patriotike, sidomos me përhapjen e veprave shqipe, leximin e tyre si dhe krijimin e disponimit të përgjithshëm për shkollën shqipe dhe arsimin shqip, gjë që ata do t’i ndihmojnë shumë thellimit të klimës së përqaftimit të alfabetit me shkronjat latine, që kishte shumë kundërshtarë edhe ndër Shqiptarët, qoftë pse shumë prej tyre kishin rënë nën ndikimin e ulemave fanatikë, qoftë pse Xhonturqit në mënyra të ndryshme, do të stimulojnë këtë sjellje.

Edhe bektashinjtë, ndonëse që nga fillimi do të përkrahin Revolucionin Xhonturk dhe do të vihen në anën e tij, nuk iu bashkuan fushatës së Xhonturqve kundër alfabetit latin dhe propagandës së organizuar prej tyre për përkrahjen e alfabetit me shkronja arabe. Përfaqësuesit e bektashinjve në të gjitha pjesët e vendit mbrojtën qëndrimet e Kongresit të Manastirit dhe të drejtën e Shqiptarëve për alfabet të tyre. Disa prej tyre madje iu bashkuan grupit të militantëve të mbrojtëseve të alfabetit me shkronjat latine dhe qenë në gjendje që për kauzën e tij të marrin në dorë edhe armët.<sup>1350</sup>

Krahas predikimit të religjionit me një gjuhë tjetër nga ajo e njohur e hoxhallarëve me anën e urdhrave të prera, bektashinjtë do të pranojnë logjikën e pajtimit të të kundërtave jashtë konfrontimeve Lindje-Perëndim dhe po ashtu do të pranojnë identitetin kombëtar, që nuk binte në kundërshtim me besimin. Në fazat e mëvonshme, bektashinjtë do të pranojnë edhe lëvizjet kombëtare dhe do të vihen në anën e kërkesave për emancipim kombëtar dhe madje shumë prej klerikëve të lartë do të marrin pjesë në këtë proces.

Siç është thënë edhe më lartë, në periudhën intensive të Lëvizjes Kombëtare teqetë do të kthehen në shkolla, në klube dhe qendra të shprehjes së identitetit kombëtar shqiptar. Andaj, nuk është e rastit që edhe tre nga rilindësit më të spikatur dhe të merituar të zgjimit kombëtar, vëllezërit Frashëri: Abdyli, Samiu dhe Naimi vinin nga një familje pasuese e kamotshme e urdhrit bektashi.

Vepra poetike e Naimit, në masë të madhe, do të jetë e ndikuar nga fryma *sufiste* e bektashizmi. Vargjet e Naimit nga vëllimi poetik “*Lulet e verësë*”, ku filozofia e panteizmit, pra ajo me të cilin shpjegohej kapërcimi i shpirtit dhe bartjes së tij nga objekti në objekt, pra i një vazhdimësie të përhershme,<sup>1351</sup> ende pa u botuar

<sup>1350</sup> Më gjerësisht rreth depërtimit të bektashinjve në Shqipëri që nga shekulli XV e tutje shih Schwartz, Stephen: “*Islami tjetër*”, Prishtinë, 2009.

<sup>1351</sup> Naim Frashërit: “*Vepra I*”, Prishtinë, 1986, faqe 26.



mirë do të gjejnë rrugën e teqeve shqiptare nga jugu e deri në veri dhe aty do të lexohen dhe këndohen pa pushim, që bashkë me ato nga “*Bagëti dhe bujqësia*” do të kthehen në një burim frymëzimi i atdhedashurisë së masave analfabete me shumicë ndër më të fuqishmit e kohës.

Megjithëse Komiteti Qendror “*Bashkim dhe Përparim*” kishte deklaruar se nuk do të përzihej në çështjen e zgjedhjes së alfabetit të gjuhës shqipe, në të vërtetë ai mobilizoi kundër Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe në mënyrë të veçantë kundër klubeve e shkollave shqipe gjithë administratën shtetërore, qendrore e lokale, klerikët fanatikë myslimanë dhe ekspeditat e gjeneralëve osmanë.<sup>1352</sup>

Në këtë veprimtari Xhonturqit u mbështetën në ligjin mbi “*Bandat*”, si dhe në ligjin “*Mbi shoqëritë*”, që ndalonte të gjitha organizatat kombëtare, përveç atyre osmane. Këto dy ligje u miratuan në parlamentin osman në vjeshtën e vitit 1909, me gjithë kundërshtimin e kombësive joturke, ku një pjesë e mirë e deputetëve shqiptarë ishin më të zëshmit dhe paralajmëruan për pasojat që do të kishte kjo për stabilitetin e vendit.

Por, Xhonturqit, duke u mbështetur në vendimet e parlamentit, si “*zë të popullit*”, do të fillojnë marrjen e masave që do të çojnë deri tek ato që do të shfaqen kundërshtime të hapura me Shqiptarët, që si do të shihet, pas pak do të arrijnë pikën e vlimit dhe me këtë do t’i hapet rruga një krize të madhe, që Shqiptarët serish do t’i kthejë në protagonistë vendimtar të rrënimit të Perandorisë Osmane. Kështu, në kërkim të konflikti me Shqiptarët, në shtator të vitit 1909, me urdhër të valiut të Kosovës u mbyllën sholla shqipe e Pejës, ndërsa në janar u mbyll edhe ajo e Gjilanit. Në shkurt të vitit 1910 vali i Kosovës urdhëroi të mbyllën të gjitha shkollat shqipe të këtij vilajeti dhe të hiqej mësimi i gjuhës shqipe nga shkollat shtetërore. Në fillim të vitit ministri i arsimit deklaroi se “*qeveria Osmane do të qëndrojë e paanshme në punët e alfabetit, por në shkollat shtetërore do të vërë në zbatim alfabetin arab*”.<sup>1353</sup>

Qeveria osmane, megjithatë, nuk do të qëndrojë “e paanshme” në punët e alfabetit, siç thoshte. Përkundrazi, krahas masave të njohura ligjore, që do t’i ndërmarrë për heqjen e gjuhës shqipe nga shkollat shtetërore, ajo do të vërë në veprim edhe faktorët e tjerë fetarë, shtetërorë dhe politikë që të veprojnë për të parandaluar alfabetin latin që të legjitimohej plotësisht tek Shqiptarët. Në këtë drejtim, krahas mbajtjes së shumë tubimeve nëpër disa qendra të Vilajetit të Kosovës, atij të Shkodrës, ku

---

<sup>1352</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 419.

<sup>1353</sup> Po aty, faqe 420.

disa klerikë myslimanë dhe fanatikë, do të demonstrojnë kundër shkollës shqipe dhe alfabetit latin, ajo do të instrumentalizojë edhe disa nga deputetët shqiptarë me qëndrimet e tyre të njohura proturke, ndër të cilët Mahmut Bedriun (nga Peja), Haxhi Ali Elbasanin, Fuat Pashën e Prishtinës, Sait Efendiun (Idrizin) e Shkupit, HasanBasriun e Dibrës dhe Riza Efendinë e Shkodrës, të cilët në Parlament, në emër të “shprehjes të ndjenjave të popullit shqiptar”, të kërkojnë nga kryeministri në janar të vitit 1910, të urdhërojë të përdorej alfabeti arab për shkrimin e shqipes dhe të ndalo-hej ai latin.<sup>1354</sup>

Kjo nxitë deputetët atdhetarë Ismail Qemalin, Hasan Prishtinën, Nexhip Dragën, Shahin Kolonjën dhe të tjerë, që t’i dërgojnë një letër proteste kryeministrit, ku kërkohej që të respektohen të drejtat e ligjshme të Shqiptarëve, në mënyrë që të lieshin të lirë të përdornin alfabetin që dëshironin dhe që administrata qeveritare të mos ndërhynte.<sup>1355</sup>

Përpyekjet e hapura të xhonturqve kundër gjuhës shqipe dhe të klerit fanatik mysliman në vilajetet shqiptare kundër arsimit shqip dhe shkronjave shqipe, duke kërkuar që ato të zëvendësoheshin me arabe, bënë që në Manastir të mbahej Kongresi i Dytë, ku iu dha përkrahje alfabetit të përbashkët, të aprovuar në Kongresin e Parë para dy vitesh në Manastir.

Kështu, *Kongresi i Dytë i Manastirit* u thirr me nismën e klubit “*Bashkimi*” të Manastirit. Në Kongres morën pjesë 20 delegatë, që përfaqësonin 34 klube e shoqëri të vilajeteve të Shkodrës, të Kosovës, të Manastirit e të Janinës, si dhe klubet shqiptare të Stambollit, të Selanikut e të qendrave të tjera.

Ndryshe nga kongreset e mëparshme kombëtare, në këtë kuvend pati një numër mjaft të madh delegatësh nga qytetet e vilajeteve të Kosovës dhe të Manastirit, nga Peja, Gjakova, Gjilani, Mitrovica, Vuçitërna, Shkupi, Tetova, Dibra, Struga, Ohri, etj. Midis delegatëve ishin Dervish Hima, Fehmi Zavalani, Petro Nini Luarasi, Hysni Curri, Ferit Ypi, Bedri Pejani, Qamil Shkupi, Gjergj Qiriazi, Bejtullah Gjilani, Themistokli Germenji, Tefik Panariti, Hajdar Blloshmi, Abdylah Efendiu (Strugë), Qazim Iliaz Dibra, Rexhep Mitrovica dhe Xhafer Kolonja. Kryetar kongresi u zgjodh Bedri Pejani, ndërsa sekretarë Ferit Ypi dhe Petro Nini Luarasi.<sup>1356</sup>

Aktet kryesore të Kongresit të Dytë të Manastirit ishin Programi prej 10 pikash dhe një Promemorje prej 4 pikash, që iu drejtua qeverisë osmane.

---

<sup>1354</sup> Po aty, faqe 420.

<sup>1355</sup> Po aty, faqe 420.

<sup>1356</sup> Po aty.

Në këto dokumente parashikoheshin masa të rëndësishme për zhvillimin e arsimit kombëtar, për mbrojtjen e alfabetit të shqipes me shkronja latine, për botimin e librave dhe të teksteve shkollore shqipe. Për këtë qëllim do të ngrihej pranë klubit qendror një komision arsimor-kulturor, që në program quhej Akademi, i cili do të merrej me botimin e teksteve shkollore, të veprave letrare dhe të një fjalori shqip-turqisht e anasjelltas. Parashihej të hapej në Shkup një shkollë normale me konvikt, e ngjashme me atë të Elbasanit, dhe të themelohej këtu një gazetë e re në shqipe dhe në turqisht, me anën e së cilës do informoheshin Shqiptarët dhe opinionin publik europian me ngjarjet që po zhvilloheshin në këtë vilajet.<sup>1357</sup>

Duke parë se pas Kongresit të Dytë të Manastirit, të mbajtur midis 2 dhe 3 prillit të vitit 1910 pjesa më e madhe e Shqiptarëve tashmë ishin përcaktuar për alfabetin me shkronja latine, ose me shkronja të veçanta, por ku në tërësi refuzoheshin ato arabe, bëri që qeveria e Stambollit t'u kthehej masave represive kundër zgjimit kombëtar shqiptar në rritje e sipër, ani pse ato nuk do t'ia ndalin hovin që kishte marrë, pos që do ta nxisin edhe më shumë dhe në shkallë të gjerë.<sup>1358</sup>

Me një dekret të njëanshëm, qeveria e Stambollit mbylli shoqëritë dhe klubet shqiptare, ndaloi shtypin, gazetat në gjuhën shqipe, mbylli shkollat shqipe, sikundër edhe shtëpitë botuese në Manastir e Selanik duke hequr, në të njëjtën kohë, gjuhën shqipe nga programi i shkollave qeveritare.

Këtij akti vandal, që do të çojë tek acarimet e papajtueshme midis Shqiptarëve dhe Xhonturqve dhe madje do të bëhet edhe shkak për largimin e tyre nga pushteti pas pak, paraprakisht do t'i prijë një deklaratë e ashpër e vezirit të madh, Ibrahim Haki Pasha, i cili në parlamentin turk, pos të tjerash, do të deklarojë:

*“Qeveria e konsideron dëshirën për adoptimin e shkronjave latine (nga ana e Shqiptarëve) si hapin e parë të shkëputjes nga Turqia... Qeveria duhet të bëjë çmos dhe do të bëjë çdo gjë që të ndalojë adoptimin e alfabetit latin”.*<sup>1359</sup>

Po me nxitjen e qeverisë turke, *Sheyhyl islam*, autoriteti suprem mysliman, u dërgoi gjithë myftinjve të Shqipërisë, më 5 prill 1910, një letër-qarkore ku thuhej:

*“Nxitojmë t’ju bëjmë të njohur se me 22 mars 1326 (1910), përmes një letre zyrtare Ministrisë së Arsimit, ne i kemi tërhequr vëmendjen asaj (Ministrie) që të mos pranojë alfabetin latin për gjuhën shqipe dhe të ketë mendjen që përdorimi i tij në shkollë të ndalohet rreptësisht dhe prandaj ne ua drejtojmë këtë letër-*

<sup>1357</sup> Po aty.

<sup>1358</sup> Aktet e Arkivit të Austrisë HHStA, PA XIV/24, Albanien XIV.

<sup>1359</sup> Po aty.

*qarkore gjithë myftinjve të qyteteve dhe krahinave shqiptare që të veprojnë sikundër porositen*”,<sup>1360</sup>

Të kësaj natyre, pra si përpjekje të fundit, që do të dështojnë, janë edhe ato që Xhonturqve, të cilët, për t’iu kundërvënë alfabetit shqip me shkronja latine dhe gjoja para të tjerëve për të treguar lojalitetin e Shqiptarëve ndaj shkronjave arabe, në prill të vitit 1910 në Stamboll themeluan një klub të quajtur “*Arnavud Mahfit-u mearifi*” (*Rrethi arsimor shqiptar*) ku propagandoheshin shkronjat arabe. Klubi kryesohej nga kleriku e senatori Haxhi Ali Elbasani, që ishte edhe deputet i parlamentit, Mahmut Bedriu, deputet i Pejës dhe të tjerë. Përveç kësaj, një gazetë në gjuhën shqipe me shkronja arabe u botua për herë të parë e të fundit në Stamboll.<sup>1361</sup>

Ky aktivitet, si do të shihet, nuk do t’ia dalë që të shtrihej në vilajetin e Kosovës, siç paralajmërohej. Madje, ai do të kundërshtohet nga “*Shoqëria e të Rinjve Shqiptarë Intelektualë*”, e themeluar nga studentët Shqiptarë të Universitetit të Stambollit, e cila qëndronte hapur në mbrojtje të shkrimit latin me çka Xhonturqit dhe fanatikët islamistë do ta humbin betejën me Shqiptarët edhe në kryeqendrën e Perandorisë, ku gjithnjë kishin menduar se kishin mbështetësit më të fortë ngase Shqiptarët prej shekujsh ishin kthyer në një pjesë të rëndësishme të elitës shtetërore dhe ushtarake, të cilët nga majat kishin qeverisur Perandorinë dhe i kishin ndihmuar ngritjes dhe forcimit të saj.<sup>1362</sup>

---

<sup>1360</sup> Po aty.

<sup>1361</sup> Po aty.

<sup>1362</sup> Shih “*Leka*”, Shkodër, XII (1940), dokumentet nr. 36,377, faqe 39-42, 45-47.

## KAPITULLI I TETË

### PARLAMENTARIZMI I DYTË (1908-1912) DHE SHQIPTARËT

#### SHQIPTARIZMI DINAMIK DHE KONFLIKTET ME CENTRALIZMIN NACIONALIST OSMAN

Shqiptarët luajtën një rol të rëndësishëm në revolucionin e korrikut. Në Ferizaj, prijësit fisnorë, feudalët dhe aristokratët e qyteteve morën angazhimin për të nisur kryengritjen dhe kërkuan rivendosjen e kushtetutës, por po kështu vepruan për sa i përket Sulltan Hamitit dhe në mbrojtje të vatani.<sup>1363</sup>

Ndryshe nga “Lidhja Shqiptare e Prizrenit” e vitit 1878, e cila u përqendrua tek çështja e ruajtjes së trojeve shqiptare duke nxjerrë kërkesën për bashkimin e tyre në një vilajet i cili do të qeverisje prej tyre në kuadër të Perandorisë Osmane, këtë herë ata morën pjesë në një përpjekje më të madhe osmane për të zëvendësuar regjimin despotik me qeverinë kushtetuese. Kështu që më të drejtë mund të thuhet se Revolucioni i korrikut Shqiptarët i gjeti më të vetëdijshëm nga ana kombëtare dhe më luftarak nga ana politike. Periudha e dytë kushtetuese krijoi një kontekst të ri për ligjërimin publik. Në vitin 1878 Sulltan Hamiti e kishte mbyllur tashmë parlamentin përpara krijimit të “Lidhjes Shqiptare të Prizrenit” dhe shfaqjes së çështjes shqiptare, e cila prej tyre kërkohet të zgjidhet me mjete politike. Në vitin 1908, një shqiptarizëm dinamik u shfaq përpara hapjes së parlamentit, i gatshëm që të vazhdohej aty ku kishte mbetur para tridhjetë e saj vitesh.<sup>1364</sup>

Tani, deputetët Shqiptarë, shumë prej të cilëve përfaqësonin një brez të ri të dalë nga udhëheqësit e “Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”, fituan një forum publik për të debutuar me imunitet rreth politikave qeveritare. Nga ana tjetër e peshores, Komiteti Xhonturk solli në pushtet një udhëheqje të re dhe të vendosur politike, e cila vepronte më shpejt sa duhej “*për të shtypur sistemin e kullave në periferi të Pe-*

---

<sup>1363</sup> Gawrych, George: “Gjysmëhëna dhe shqiponja”, Tiranë, 2007, faqe 256.

<sup>1364</sup> Po aty, faqe 257.

*randorisë*”,<sup>1365</sup> me çka do të hapen “fronte” e brendshme, kryesisht me Shqiptarët, më të merituarit për ardhjen e tyre në pushtet dhe kthimin e parlamentarizmit.

Krahas vështirësive, shpërputhjeve dhe në fund të konfrontimit të hapur me Xhonturqit, të cilat do të kulmojnë me kryengritje të mëdha në Kosovë, siç do të jenë ato të viteve 1910-12, të cilat do të sjellin te shpallja e shtetit shqiptar dhe rrënimi i Perandorisë Osmane, mund të thuhet se kohën katërvjeçare të parlamentarizmit të dytë dhe të kushtetutës (1908-1912), Shqiptarët do ta shfrytëzojnë për luftën politike dhe mjetet e saj legale për të vepruar në kuadër të parlamentit, qeverisë dhe të institucioneve, në mënyrë që të arrihen të drejtat e tyre qytetare në përputhje me kushtetutën. Njëherësh, jeta parlamentare, përkundër trysnive që do t’i vinë nga Xhonturqit dhe përpjekjet e tyre që të mbikëqyrin që të gjitha poret e jetës me përkushtimin e skajshëm që t’i jepej ngjyra e një nacionalizmi centralist osman të një shkalle fanatizuese, megjithatë Shqiptarët jo vetëm që nuk do të heqin dorë nga kërkesat e tyre për emancipim kulturor, shoqëror dhe kombëtar, por do t’ia dalin që t’ia ruajnë vazhdimësinë kursit që lidhej me të drejtën që të njiheshin si komb dhe atë për autonomi administrative dhe politike në kuadër të Perandorisë Osmane. Edhe atëherë kur do të jenë të detyruar që nga shumica Xhonturke në parlament të mbivotohen, edhe kur pushteti centralist me anën e fushatave ushtarake dhe provokimeve të shumta do të mundohet t’i nxjerrë jashtë ligjit shumë nga prijësit vendorë (feudalë), përkrahës të sulltan Hamidit dhe absolutizmit të tij, ndaj të cilëve do të ndërmerren masa drastike ndëshkuese, masa këto do të prekin një pjesë të madhe të popullatës së vilajetit të Kosovës dhe atij të Shkodrës, klasa politike shqiptare do të silltet me përgjegjësi dhe në përputhje me besimin e fituar nga votuesit.

Besimin e votuesve nga krahinat shqiptare për parlamentin osman e fituan 26 deputetë, nga të cilët vetëm një pjesë prej tyre, si Ismail Qemali, Hasan Prishtina, Nexhip Draga, Shahin Kolonja, Bedri Pejani e të tjerë, përfaqësonin forcat atdhetare shqiptare, që vepruan në parlament si kundërshtarë të politikës së Xhonturqve ndaj Shqiptarëve.

Besimi i fituar për deputetët Shqiptarë kaloi nëpër rrethana shumë diskriminuese, sepse ligji elektoral i shpallur nga Xhonturqit me 15 shtator 1908 nuk njihi kombësitë joturke dhe i shpallte të gjithë banorët e Perandorisë “osmanlinj”, gjë që për të konkurruar për deputet vihej kusht pranimi i përkatësisë osmane, njohja e gjuhës turke, si dhe caktimi i një censi të lartë pasurie, duke përjashtuara nga zgjedhjet shtresa të gjera të popullsisë qytetare. Për shkak të shkeljes së ligjit elektoral, popull-

---

<sup>1365</sup> Po aty, faqe 258.

sia katolike e Shkodrës, bojkotoi zgjedhjet dhe ashtu veproi edhe popullsia e Mitrovicës, në Vilajetin e Kosovës, ku Isa Boletini, miku i madh dhe i përhershëm i sulltanit, kishte feudin e vet dhe gëzonte mbështetje te një pjesë e mirë e popullatës. Përveç kësaj, Xhonturqit përdoren të gjitha mjetet për t'i detyruar zgjedhësit të vononin për deputetët turq e proturq, që kandidatë të Komitetit “*Bashkim e Përparim*”.<sup>1366</sup>

Për t'u parë sa diskriminuese ishte kjo fushatë nga Xhonturqit, e cila nuk kurseu edhe themeluesit e partisë, ata që kishin bërë më së shumti për ngritjen dhe forcimin e saj, por që pas fitores së revolucionit nuk i shkonin për lalë kursit të ri nacionalist-centralist që ndiqte grupi udhëheqës me përkatësi fanatike osmane, dëshmon më së miri edhe humbja e Ibrahim Temos në sanxhakun e Elbasanit nga kandidati xhonturk Abdylah Mahir efendiut. Temo, edhe pse ishte themelues i Komitetit “*Bashkim dhe Përparim*” dhe njëherësh njëri ndër më të merituarit e Lëvizjes së madhe opozitare në Perandorinë Osmane, nuk pati mbështetjen e partisë së vet, pikërisht pse osmanizmin politik nuk dëshironte ta ndante e aq më pak ta konfrontonte me shqiptarizmin dhe interesat e tij.<sup>1367</sup>

Peripeci të ngjashme patën edhe Ismail Qemali në Vlorë, Hasan Prishtina në sanxhakun e Prishtinës përkatësisht të Vlorës dhe atdhetarë të tjerë shqiptarë, të cilët ia dolën të fitojnë, por me mund të madh, meqë për kundërshtarë nuk kishin vetëm kundër-kandidatët nga radhët e Xhonturqve por edhe komitetet e tyre vendore, që nuk ngurruan që për qëllime fushate në disa pjesë të përdorin edhe dhunën policore dhe ushtarake madje.

Edhe përkundër këtyre masave, një numër i mirë i atdhetarëve shqiptarë ia dolën që të futen në Parlamentin Osman dhe kjo do të jetë edhe një sprovë e rëndësishme e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare që në rrethanat e parlamentarizmit, të cilat më së paku ishin demokratike, të luftonin për interesat e tyre. Kjo edhe do të ndodhë. Ismail Qemali, i cili do të zgjidhet udhëheqës i grupit të deputetëve shqiptarë në parlament, njëherësh u vu në krye të opozitës liberale, e cila në dhjetor të vitit 1908 u shndërrua në një parti më vete me emrin “*Ahrar*” (“*Liberalët*”). Kjo parti bashkonte rreth vetes edhe deputetët e kombeve të tjera të Perandorisë Osmane: Kurdët, Armenët, Arabët, që shfaqeshin me kërkesat për decentralizimin e administrimit të Perandorisë Osmane dhe për vetëqeverisjen e provincave kombëtare.<sup>1368</sup>

“*Liberalët*”, edhe pse nuk do të kenë thujse kurrfarë hapësire veprimi në parlamentin e dominuar nga Xhonturqit, dolën me kërkesat për vetëqeverisjen e

<sup>1366</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 396.

<sup>1367</sup> Shih: Prifiti, Kristaq: “*Doktor Ibrahim Temo*”, Prishtinë, 1996.

<sup>1368</sup> Po aty, faqe 397.

provincave kombëtare dhe për arsimin kombëtar në Shqipëri dhe në Maqedoni, gjë që kjo u përçoll me demonstrim të ashpër nacionalist të Xhonturqve, të cilët paralajmëruan marrjen e masave të ashpra ndaj gjithë atyre të cilët dobësojnë centralizmin osman. Me këtë rast gishti u drejtua nga vilajetet shqiptare, të cilat u zunë në gojë si mbështetëse të qeverisjes absolutiste të Sulltan Hamitit, që dëshirojnë të mbesin jashtë mbikëqyrjes së ligjit dhe të rendit. Madje, që të disiplinohen të tillët, Xhonturqit filluan fushatën kundër Isa Boletinit, pasi që ai nuk pranoi për t'u futur në Komitetin "*Bashkim e Përparim*".<sup>1369</sup>

Isa Boletini, i cili do të ruajë respektin për Sulltan Hamitin, dhe si do të shihet në disa raste do të përpiket që të trimërojë përkrahësit e tij kundër Xhonturqve, fillimisht do të mundohet t'u ikë fesateve me kajmekamin e ri të Mitrovicës duke u tërhequr në Boletin. Por, nuk do të vonojë dhe ai do të shpallet "kundërshtar" i kushtetutës. Kundër tij do të nisët një fushatë ndëshkuese prej 1.500 ushtarësh, të pajisur me artileri. Pas luftimeve të para jo të barabarta, Isa Boletini, me përcjellësit e tij u tërhoq në fshatrat përreth për t'u vendosur më pas në Isniq të Pejës.<sup>1370</sup>

Forcat ndëshkimore ushtarake të divizionit 18 të Mitrovicës të komanduara nga Xhavit Pasha, edhe atje do t'i vihen pas dhe në mars të vitit 1909 do ta rrethojnë Isniqin me rrethinë dhe do të kërkojnë dorëzimin e tij. Boletini do të tërhiqet prej andej, por mllefi i ushtrisë turke nuk do ta kursejë këtë vend dhe rrethinën nga shkatërrimet që i erdhën prej topave.<sup>1371</sup>

Fushata ndaj Isa Boletinit dhe masat e tjera që do të ndërmarrë Xhavit Pasha në Kosovë, siç ishin ato për vjeljen e tatimeve dhe për zbatimin e ligjit për shërbimin e detyrueshëm ushtarak, që i nënshtroheshin që të gjithë shtetasit e Perandorisë, acaruan së tepërmi gjendjen në vend. Në pjesë të ndryshme zunë të shfaqen protestat dhe rezistenca e armatosur, e cila nisi të marrë përmasa gjithnjë e më të mëdha duke u filluar nga Mitrovica, Peja, Prizreni e Prishtina për t'u shtrirë deri në Dibër. Përleshje të armatosura me ushtrinë osmane pati edhe në disa pjesë të Shqipërisë së Mesme, të cilat pastaj kaluan edhe në atë të Jugut. Të ashpra ishin reagimet e ekspeditave osmane ndaj atyre që nuk dëshironin t'i nënshtroheshin detyrimit të shërbimit ushtarak. Bëhet e ditur se autoritetet Xhonturke për të thyer rezistencën e Shqiptarëve kundër përfshirjes në ushtrinë osmane, vetëm në Janinë, në mars të vitit 1909, pushkatuan 80 ushtarë Shqiptarë.<sup>1372</sup>

---

<sup>1369</sup> Po aty, faqe 398.

<sup>1370</sup> Po aty, faqe 398.

<sup>1371</sup> Po aty, faqe 398.

<sup>1372</sup> Po aty, faqe 399.



Politika nacionaliste xhonturke, e cila me të shpejtë do t'i harrojë kërkesat për "liri, barazi, vëllazëri pa dallim feje e etnie" me të cilat kishte bërë për vete kombet e ndryshme të Perandorisë Osmane dhe i kishte tërhequr drejt revolucionit, zhgënjëu jo vetëm Shqiptarët, që kishin bërë më së shumti që ata të vinin në pushtet, por dëshpëroi edhe shumë nga nismëtarët e saj, të cilët e kishin përfytyruar ndryshe rolin e këtij zhvillimi.

Këtë gjendje do ta shfrytëzojnë përkrahësit e Sulltan Hamitit, por edhe opozita "Ahrar", të cilët do të marrin pjesë në një komplot kundërrevolucionar, siç është quajtur ai në histori, edhe pse nuk ishte i tillë, pasi që fjala ishte për një rebelim të pasuksesshëm ushtarak, që do të shuhet shpejt.

Pa marrë parasysh si do të vlerësohet ajo ngjarje, mund të thuhet se opozitarët nga radhët e "Ahrarit", duke pasur përkrahjen e disa përfaqësuesve të parisë dhe të klerikëve turkomanë të Dibrës dhe të Kosovës, shpresonin të bënin për vete Shqiptarët e veçanërisht repartet ushtarake shqiptare të pakënaqura nga regjimi xhonturk, që vlerësoheshin vendimtare gjatë ndryshimeve të tilla.<sup>1373</sup> Pse nuk do të ndodhë kjo në masën e duhur, arsyet sigurisht që duhet kërkuar tek frika e përfshirjes në ngjarje të cilat nuk kishin gjithaq qartësi dhe, ç'është më e rëndësishme - pse Shqiptarët nuk do t'i bashkohen thirrjes së "Ahrarit"- kjo kishte të bënte me atë se as Sulltan Hamiti, përkundër fjalëve të mëdha, nuk kishte qenë në gjendje që të mbronte interesat e Shqiptarëve në raport me Fuqitë e Mëdha dhe veçmas me fqinjët sllave, të cilëve u kishte dhënë privilegje të mëdha në dëm të Shqiptarëve, privilegje këto që megjithatë, me ardhjen e Turqve të Rinj në pushtet, kishin pushuar të ishin të tilla.

Sidoqoftë, një pjesë e oficerëve shqiptarë, të drejtuar nga Hamdi Çausi dhe disa nga feudalët (Isa Boletini) kishin përkrahur atë që do të quhet kundërrevolucion dhe me anën e forcave ushtarake që ia vunë në dispozicion pasqyronin elementet e politikës së vjetër, të lidhur pas Sulltan Hamitit me anën e privilegjeve dhe përkrahjes që gëzonin prej tij.<sup>1374</sup>

Ka shumë gjasa që dhe Ismail Qemali të ketë luajtur rol në kryengritjen e parë, duke bindur Dhomën e Ulët për të pranuar qeverinë e re të formuar nga Sulltan Hamiti,<sup>1375</sup> edhe pse gjatë një hetimi akuza për komplot do t'i hiqej.

---

<sup>1373</sup> Gawrych, George: "Gjysmëhëna dhe shqiponja", Tiranë, 2007, faqe 255.

<sup>1374</sup> Po aty, faqe 255.

<sup>1375</sup> Rreth rolit të Shqiptarëve në kryengritjen e parë më gjerësisht shih: Gawrych, George: "Gjysmëhëna dhe shqiponja", Tiranë, 2007; Ismail Qemal Vlora: "Kujtime", Tiranë; Eqrem bej Vlora: "Kujtime", Tiranë, 2001; Bartl, Peter: "Die Albanischen Muslime zur Zeit der Nationalen Unabhängigkeitsbewegung 1878-1912", Wisbaden, 1968; Clyer, Nathali: "Në fillimet e nacionalizmit shqiptar", Tiranë, 2009.

Megjithatë, rol vendimtar në përndezjen e flakës së këtij rebelimi luajtën trupat e Armatës së Parë, shumica shqiptarë, (ato që ruanin Sulltanin dhe pallatin) të cilat nuk do të pranojnë t'u nënshtrohen urdhrave të ministrit të luftës që të shkonin në shërbim në Jemen, meqë kjo ua dobësonte privilegjet që kishin në kryeqytet. Xhonturqit, megjithatë do të vazhdojnë që pas largimit të dy batalioneve besnike të Sulltanit nga radhët e Shqiptarëve për në Manastir, të marrin edhe masa të tjera që Sulltan Hamitin dhe pallatin ta privojnë nga çfarëdo pushteti, gjë kjo që shkaktoi reagimin e njësive besnike të Sulltanit nga radhët e Armatës së Parë, të cilave iu bashkuan edhe studentët e teologjisë dhe elementë të tjerë të popullsisë së kryeqytetit, dhe së bashku ata marshuan në sheshin para Aja Sofisë ku kërkuan zbatimin e ligjit të shenjtë të fesë islame.<sup>1376</sup>

Duke mos qenë në gjendje që të qetësonin demonstruesit, Hysein Hilmiu, veziri i madh, paraqiti dorëheqjen e tij dhe, më 14 prill, Sulltani zgjodhi me të shpejtë një pasardhës tjetër, i cili ishte kandidat për sulltanatin e tij. Gjatë kryengritjes, demonstruesit qëlluan një numër oficerësh të ushtrisë dhe dogjën disa zyra të Komitetit "*Bashkim e Përparim*", që ishin kthyer në shtet në pushtet.

Rrjedha e ngjarjeve, megjithatë, nuk do të shkojë në dobi të asaj që do të quhet kundërrevolucion, meqë Xhonturqit me të shpejtë do të fitojnë përkrahjen e Mahmut Shefqet Pashës, ish vali i Kosovës, që tashmë ishte komandant i Armatës së Tretë, shtabi i së cilës ndodhej në Selanik, e ku Shqiptarët po ashtu luanin një rol të rëndësishëm. Ai pranoi ftesën për ta shuar kryengritjen.

I mbështetur nga komandanti i Armatës së Dytë, që kishte shtabin në Edrenë, Mahmut Shefqet Pasha formoi të ashtuquajturën "*Ushtri e Veprimit*" (*Hareket Ordusu*), e cila deri sa arriti në Stamboll numëronte deri në 25 mijë trupa të rregullta, si dhe 15 mijë vullnetarë, duke përfshirë në kategorinë e fundit 4000 Bullgarë, 2000 Grekë dhe 700 Çifutë. Bajram Curri dhe Çerçiz Topulli sollën me vete 8000 Shqiptarë; Njazi beu ua shtoi këtyre trupave 1800 vetë nga Resnja. Më 24 prill, kjo forcë e përbërë nga kombet të ndryshme (me mbi gjysmën Shqiptarë) hyri me lehtësi në Stamboll dhe shtiu shpejt në dorë qytetin.<sup>1377</sup>

Komiteti vendosi të përdor atë që e cilësoi kundërrevolucionin si një mjet për të përmbysur nga fronin Sulltan Hamitin dhe, më 27 prill, katër anëtarët e Komitetit "*Bashkim dhe Përparim*", e vunë në dijeni Sulltanin për shfronësimin e tij. Grupi përbëhej nga dy myslimanë Shqiptarë (njëri ndër ta ishte Esad Pashë Toptani), një

---

<sup>1376</sup> Gawrych, George: "*Gjysmëhëna dhe shqiponja*", Tiranë, 2007, faqe 254.

<sup>1377</sup> Po aty, faqe 254.

çifut dhe një armen. Dekretin për shfronësim Sulltanit do t'ia dorëzojë Esad Pashë Toptani me fjalët:

*“Kombi ju ka hequr nga fronti”*.<sup>1378</sup>

Reshat efendiu (1848-1918), vëllai i Abdyl Hamitit, u bë Sulltan i ri, Mehmeti V, i cili sundoi deri në vrasjen e tij, në vitin 1918. Abdyl Hamiti u deportua në Selanik, ku qëndroi nën arrest shtëpie derisa Lufta e Parë Ballkanike serish e solli në Stamboll.

Pas shtypjes së kundërrevolucionit, Komitetit *“Bashkim dhe Përparim”* dhe Mahmut Shefqet Pasha dolën në pah si dy vatra kryesore të pushtetit politik. Mahmut Shefqet Pasha u vu në krye të armatës dhe këtë e bëri në emër “të meritave” se kishte shpëtuar revolucionin. Së pari mori përsipër postin e inspektorit të përgjithshëm të tre Armatave të Para, një komandë e re që atij i shkonte për shtati, dhe më pas, në janar të vitit 1910 u bë ministër i luftës, një post që e mbajti derisa dha dorëheqje, më 9 korrik 1912.<sup>1379</sup>

Për “ta shpëtuar shtetin”, Komiteti *“Bashkim dhe Përparim”* dhe ushtria u përgjigjën me politika centraliste ndër më të ashprat, që bëheshin me pretekstet e “kthimit të rendit” aty ku ishte prishur, ose kundërshtojë. Për Shqipërinë, e cilat tashmë gëzonte anatemen e *“vendit jashtë ligjit”*, konstrukt ky i ndërtuar nga propaganda serbo-ortodokse që nga koha e Krizës Lindore e tutje me të cilën i hapeshin dyert rrënimit të identitetit të saj etnik dhe i përqaftuar nga Xhonturqit për qëllime thuajse të njëjta, do të thoshte fushatë ushtarake për vendosjen e rregullit dhe të sigurisë, që për çmim kishte humbjen e shumë privilegjeve (qeverisja vendore sipas kanunit, mbajtja e armëve dhe mospagimi i shumë taksave), që kishin gëzuar gjatë tre shekujve të fundit. Kishte ikur pra koha e absolutizmit dhe e islamizmit të Sulltan Hamitit dhe politika e tij për t'i kthyer Shqiptarët myslimanë në një shtyllë mbështetjeje të Perandorisë Osmane në Ballkan, ani pse Sulltanati asnjëherë nuk kishte tentuar që atë përnjëmend ta jetësonte, meqë karta e islamizmit ku ai mbështetej ishte e paqëndrueshme dhe e rrezikshme madje për vetë Shqiptarët ashtu i kthente në shënjestër të fqinjëve dhe kundërshtarëve të mbetjes së Perandorisë Osmane në pjesën europiane. Në vend të saj, revolucionin i korrikut, së paku sa për sy e faqe, solli *“vizionin e rregullit dhe të përparimit”*, të bazuar në osmanizëm, i cili e vinte theksin më shumë tek *bashkimi* se sa tek *larmia* dhe që ishte gjithashtu i përzier me islamizmin dhe turqizmin.<sup>1380</sup>

<sup>1378</sup> Po aty, faqe 255.

<sup>1379</sup> Prifti, Kristaq: “Doktor Ibrahim Temo”, Prishtinë, 1996, faqe 244-249.

<sup>1380</sup> Po aty.

*Bashkimi*, i mbështetur mbi përzjerjen islamiste-turke, me të cilin të tjerëve u mohohet identiteti nacional bashkë me kërkesat për qeverisje të brendshme, nga Shqiptarët u kuptua si një tradhti e dyfishtë: në njërin anë pse nën pushtetin e ri ata humbnin aftësinë e tyre mbrojtëse, siç e kishin gjatë kohë së Sulltan Hamitit që edhe me vetiniciativë të mbroheshin në rast sulmi nga fqinjët, dhe në tjetrën anë humbnin mundësinë që qeverisjen lokale, pa marrë parasysh si dhe sa kishte qenë e hairit ta kthenin në një qeverisje politike në përputhje me programin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Se këto çështje nuk ishin të rastit, do ta tregojë aprovimi i ligjit “kundër bandave”, me të cilin armata fitonte të drejtën që të ndërhynte për të mbledhur armët aty ku ajo vlerësonte se këtu e kërkonte “interesi nacional”.

Sipas këtij ligji, Xhonturqit mund të ndërhynin në çdo pëllëmbë të tokës shqiptare pa përjashtim, sepse Shqiptarët nga koha e jeniçerëve e këndeje gëzonin “privilegjin” e mbajtjes së lirë të armëve. Por, edhe përkundër kësaj, vilajetet shqiptare nuk kishin qenë “*vende jashtë ligjit dhe rregullit*” e as “*feude bandash*”.

Në rrethanat e zbatimit të Kanunit dhe të qeverisjes vendore, arma kishte qenë pjesë e rregullit të brendshëm. Rendi i jeniçerëve, jo vetëm që ka pasur mirëkuptim për “shqiptarin e armatosur”, por atë e ka konsideruar mbrojtësin më të mirë të vatanit. Kështu që nuk ka qenë e rastit pse jeniçerët në pjesën europiane, por jo vetëm në të, në rast krizash ose luftërash, përherë janë mbështetur tek aftësia mbrojtëse e Shqiptarëve dhe gatishmëria që me armë të dëshmojnë patriotizmin perandorak, i cili njëherësh ka qenë edhe atdhedashuri.<sup>1381</sup>

Pas eliminimit të kundërrevolucionit, gjithnjë në bashkëpunim me krahun militant nga radhët e Xhonturqve, që tashmë kishin uzurpuar pjesën më të madhe të pushtetit, Mahmut Shefqet Pasha po e vente ushtrinë mbi politikën, realitet ky që do të ketë ndikim të madh edhe në zhvillimet e mëtejshme, meqë ky rol i ushtarakëve do të pasqyrohet më shumë gjatë shembjes së Perandorisë Osmane dhe lindjes së Turqisë së Ataturkut se sa në mbrojtje të osmanizmit. Sidoqoftë, në ato rrethana, ushtria tashmë e konsideronte veten “Gardiane të kushtetutës” (*Nigahban-i Mesrutiyet*), ndërkohë që Komiteti “*Bashkim dhe Përparim*” u mbështet tek ajo për të siguruar rendin dhe sigurinë pasi që edhe ashtu fryma e militarizmit

---

<sup>1381</sup> Rreth “privilegjit” të Shqiptarëve për të mbajtur armët gjatë Perandorisë Osmane si dhe rolit të tyre në jetën shoqërore dhe politike të vendit shih: “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002; Riza, Skënder: “*Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII*”, Prishtinë, 1982; Gawrych, George: “*Gjysmëhëna dhe shqiponja*”, Tiranë, 2007; Faensen, Jürgen: “*Die Albanische Nationalbewegung*”, Wiesbaden, 1980; Bartl, Peter: “*Die albanische Muslime zur Zeit der Nationalen Unabhängigkeitsbewegung 1878-1912*”, Wiesbaden, 1968; Siebertz, Paul: “*Albanien und die Albanesen*”, Wien, 1910; Godon, Marie Amelia von: “*Aus dem neuen Albanien*”, Wien, 1914; Durham, Edith: “*Brenga e ballkanasve*”, Tiranë, 2000

kishte depërtuar tek organet e saj kryesore të cilat mbanin emra të kësaj natyre si: “*Silah*” (Arma), “*Süngü*” (Bajneta), “*Biçak*” (Thika), “*Kursum*” (Plumbi) dhe “*Bomba*” dhe të ngjashme.<sup>1382</sup>

Militarizmi i politikës nga ana e Xhonturqve ishte në përputhje me doktrinën nacionaliste dhe centraliste osmane dhe duhej t’i shërbente arritjes së qëllimeve të saj. Në rrethana të tilla ushtarakët ishin ata që me veprime të drejtpërdrejta luftarake duhej t’ia hapnin rrugën “*vendosjes së rendit*”. Dhe kjo Shqiptarët do t’i ballafaqojë drejtpërdrejt me ekspeditat ushtarake, të cilat me të shpejtë do të krijojnë një gjendje shumë të acaruar, veçmas nëse kihej parasysh deklarata e Mahmut Shefqet Pashës kur ai thoshte se “*e vetmja zgjidhje për çështjen shqiptare është kërbaçi*”. Gjenerali i fuqishëm besonte shumë në shtypjen me ashpërsi të kryengritjeve.<sup>1383</sup>

Do të jetë ky një besim fatal për vetë fatin e Perandorisë Osmane, meqë mbështetja në forcën ndëshkuese dhe shtypëse të armatës si dhe përdorimi i saj për qëllime të tilla, do të sjellë militarizimin e plotë të shoqërisë osmane, që do të provokojë jo vetëm Shqiptarët, por do të provokojë edhe Fuqitë e Mëdha. Sepse, daljen në skenë të një kursi të tillë, do ta marrin si një shenjë të mjaftueshme se marrëveshja rreth ruajtjes së *status quo-s*, e arritur qysh nga Kongresi i Berlinit i vitit 1878, jo vetëm që nuk mund të mbahej më, por Xhonturqit, në këtë mënyrë, pra me shtypjen e identiteteve kombëtare me anën e kërbaçit, ktheheshin në prishësit e saj kryesor. Ishte e qartë se asnjë popull evropian, i cili ndodhej në fazën e një emancipimi kombëtar dhe shtetformues, nuk do të pranojë që të sakrifikojë interesat kombëtare për “idealet” nacionaliste-militariste osmane me anën e të cilave, nuk fitohet gjë, pos që humben edhe ato që dikur kishte paraqitur diçka.

Përballë këtyre rrethanave Shqiptarët, megjithatë, do të detyrohen të gjejnë pajtimin e brendshëm, atë që u kishte munguar në masë të madhe që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e këndeje, në mënyrë që të fusin në lojë njësoj si strukturat feudale dhe ato konservative të shoqërisë shqiptare, të cilat serish do të jenë në ballë të rezistencës për t’i penguar përpjekjet e qeverisë “për të vu më shumë kontroll”, siç do të inkurajojnë edhe rrymën e borgjezisë së re, kryesisht përkrahëse të Revolucionit Xhonturk, për të vazhduar që parlamentarizmi të shfrytëzohet për t’u paraqitur kërkesat kombëtare, pa marrë parasysh si dhe sa përfillen ato.

Rrethanat tashmë i shkonin për shtati qëndrimit të përbashkët shqiptar, sepse që të dy rrymat kishin parë se edhe Sulltanati, që tashmë i kishte shkuar koha, e

---

<sup>1382</sup> Gawrysh, Geograd: “*Gjysmëhëna dhe shqiponja*”, Tiranë, 2007, faqe 260.

<sup>1383</sup> Po aty, faqe 261.

edhe osmanizmi, të cilit i kishte ardhur koha, nuk ishin garantues të çështjes shqiptare. Përkundrazi, do të dalë në pah fare qartë, se ashtu si Sulltan Hamiti, që dikur Shqiptarët i konsideronte “barrikadë islamiste” në pjesën europiane, ngjashëm kërkonin edhe Xhonturqit me osmanizmin.

Të kuptuarit e kësaj të vërtete si dhe përshtatja rrethanave të reja, nuk ua lehtësonte punën Shqiptarëve. Sepse, duke parë se Shqiptarët nuk do të heqin dorë as nga rezistenca e armatosur, dhe nuk do të heqin dorë as nga parlamentarizmi dhe kushtetuta, që u kishin dhënë ndihmën vendimtare dhe më të rëndësishme në mënyrë që hapësirën e tyre ta shfrytëzonin për realizimin e kërkesave politike që lidheshin me autonominë, Xhonturqit dhe Mahmut Shefqet Pasha, do të mundohen që luftën ndaj këtyre ta vendosnin atje ku ajo e kishte burimin, pra duke thyer rezistencën e Shqiptarëve me mjete ushtarake në radhë të parë duke ua sulmuar ato që kishin të bënin me vetëqeverisjen e brendshme të toleruar prej shekujsh.

## RIKTHIMI I FUSHATAVE USHTRAKE NË SHQIPËRI DHE KRYENGRITJET E VITEVE 1909-1911

Xhonturqit, të drejtuar nga gjenerali Mahmut Shefqet Pasha që ua kishte mundësuar rikthimin në pushtet pas kundërrevolucionit të vitit 1909, dëshironin që kursin e tyre centralist dhe nacionalist, me anën e dhunës ushtarake, ta demonstronin në Kosovë, në njërin ndër vilajetet më të fuqishme dhe të rëndësishme shqiptar, ku Lidhja Shqiptare e Prizrenit e vitit 1878 promovoi për herë të parë kërkesën e shtetit autonom shqiptar, të cilën, madje, për një kohë edhe do ta demonstrojë përderisa do të rrënohet dhunshëm. Guvernatori i ri i Kosovës, Maxhar beu, i cili njëherësh ishte edhe anëtar i Komitetit “*Bashkim dhe Përparim*”, do të marrë udhëzime të qarta që të zbatojë një vijë të ashpër kundër Kosovës, duke u mbështetur te ligji i luftës.

Pos fushatës së ashpër për mbledhjen e taksave, dhe për zbatimin e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, ai filloi regjistrimin e plotë të popullatës, të pronës dhe të pajisjeve, duke krijuar kështu një regjim të rreptë mbikëqyrjeje, i cili rrëronte traditën dhe prekte edhe familjen. Në përputhje me këtë, ai caktoi edhe gjyqet ushtarake, të cilat kishin kompetenca që të vepronin me shpejtësi dhe ashpërsi, gjë që acaroi edhe më tutje gjendjen, e cila edhe ashtu ishte buzë shpërthimit.

Kjo sjellje do t'i detyrojë deputetët shqiptarë që çështjen ta shtrojnë në parlament dhe atje të kërkojnë përgjegjësi. Në Dhomën e deputetëve, vlonjati Mehmet

Ferid Pasha, i emëruar kohëve të fundit ministër i brendshëm, mbrojti politikën e qeverisë në Kosovë, me arsyetimin se ajo ishte në përputhje me “vendosjen e rendit”. Por, deputetët shqiptarë, të udhëhequr nga Said beu nga Shkupi dhe Hysein Fuat Pasha nga Prishtina, shprehën kritikën e tyre ndaj metodave të përdorura nga gjenerali Xhavit Pasha, të cilat përfshinin përdorimin pa dallim të artillerisë, që shkatërronin shumë shtëpi familjesh të pafajshme. Ata gjithashtu u zemëruan me mënyrën e dënimit të kryengritësve duke i konsideruar ata si “reaksonarë” (*mürtesi*).<sup>1384</sup>

Në këto debate të ashpra në Parlamentin Osman, siç pritej, mori pjesë edhe Hasan Prishtina. Ai kritikoi qeverinë për fushatë të paramenduar të qërimit të hesapeve me Shqiptarët, që ndonëse arsyetohej “me vendosjen e rendit”, në të vërtetë kishte për qëllim që ata të heqin dorë nga kërkesat e tyre politike, të cilat kishin të bënin me vetëqeverisjen (autonominë) dhe emancipimin (identitetin kombëtar) për të cilat ata kishin luftuar dhe duhej t’u plotësoheshin në vend që të provokoheshin dhe ndëshkoheshin.<sup>1385</sup>

Hasan Prishtina, kritikata e ashpra drejtuar qeverisë pse në Kosovës ia kishte lënë duart e lira Xhavit Pashës që të ushtronte terror të ashpër, i përsëriti edhe në gazetën “*Tanin*”.<sup>1386</sup> Me këtë rast ai kërkoi që në Kosovë të ndiqet shembulli i reformatorit të madh Mit’hat Pasha, i cili kishte sjellë rregull dhe mirëqenie në provincën e Danubi. Hasan Prishtina kërkonte që Porta e Lartë më në fund të kuptonte të vërtetën se nuk ishin represaliet dhe dhuna ushtarake ato që mund të kthenin normalitetin në Kosovë, por hapja e bisedimeve për kërkesat e njëmendta të Shqiptarëve, që lidheshin me autonominë e tyre brenda Perandorisë Osmane.

Çështjen e autonomisë shqiptare, si të vetmes mundësi që do të pajtonte ata me Perandorinë Osmane, por që njëherësh do të ishte edhe zgjidhja më e drejtë, me të cilën asaj do t’i zgjatej jeta në pjesën europiane, do ta ngruhe edhe Ismail Qemali në një manifest, të botuar në gazetën “*La Nazione Albanese*”,<sup>1387</sup> që do të drejtohet me thirrjen “*Vëllezërve shqiptarë*” dhe prej andej do të shpërndahet në shumë pjesë të Shqipërisë. Ismail Qemali vinte në dukje se Shqiptarët, të cilët kanë njëqind vjet që po luftojnë për të drejtat njerëzore dhe për lirinë, sot rrezikohen të humbasin si komb. Me këtë rast, duke parë thelbin nacionalist të regjimit

---

<sup>1384</sup> Po aty, 267.

<sup>1385</sup> Abdyli, Tahir: “*Hasan Prishtina – një lëvizje kombëtare e Demokratike shqiptare 1908-1912*”, Prishtinë, 2003, faqe, 40.

<sup>1386</sup> Gawrych, George: “*Gjysmëhëna dhe shqiponja*”, Tiranë, 2007, faqe 267.

<sup>1387</sup> Shih shkrimin “*Shpresa jonë, jeta jonë të jetë vetëurdhrimi i Shqipërisë*”, botuar te “*La Nazione Albanese*”, më 15 korrik 1909

xhonturk, bënte thirrje të mos i mbështesnin shpresat te Komiteti “*Bashkim e Përparim*”. Sepse, si thoshte, pas shpalljes së lirisë (kushtetuese), Shqiptarët më shumë se çdo komb tjetër shpresuan se do të kishin mundësi të punonin për përparimin e gjuhës së tyre, por u gënjyen. Si dëshmi për këtë përmenden dhunimet që po bënte Xhavit Pasha në Shqipërinë e Sipërme, si edhe përçarjet që Xhonturqit po mbillnin midis Shqiptarëve. Kështu, Ismail Qemali arrinte në përfundim se rruga e vetme, për shpëtimin e kombit nga lakmitë e të huajve, do të ishte lufta për autonominë e Shqipërisë:

“*Shpеса e jonë, jeta e jonë, lipset të jetë: Vetëurdhërimi i Shqipërisë nën hijen e Perandorisë Osmane.*”<sup>1388</sup>

Në këtë dokument Ismail Qemali parashtroi programin politik për zgjidhjen e çështjes shqiptare, që e shihte në themelimin e një shteti autonom shqiptar. Për këtë duhej të bashkoheshin të gjitha viset ku flitej gjuha shqipe, të banuara nga popullsia shqiptare, në një vilajet të vetëm, i cili do të mbante emrin “*Vilajeti Shqiptar*” (*Arnautlluk Vilajet-i*) me kryeqytet Ohrin ose Elbasanin. Në kufijtë e Shqipërisë autonome nga Vilajeti i Janinës do të përfshihen sanxhaqet e qendrës (i Janinës), Prevezës, të Gjirokastrës dhe të Beratit; nga Vilajeti i Shkodrës – sanxhaku i Shkodrës me Malësi dhe sanxhaku i Durrësit; nga Vilajeti i manastirit – sanxhaku i qendrës (i Manastirit), kazaja e Grebenës nga sanxhaku i Selifixhës, sanxhaqet e Dibrës, të Korçës dhe të Elbasanit; nga vilajeti i Kosovës - sanxhaqet e Shkupit, të Prishtinës, të Pejës dhe të Prizrenit.<sup>1389</sup>

Shqipëria autonome do të qeverisej nga një guvernator i dërguar nga Stambolli pranë të cilit do të vepronte, po si organ ekzekutiv - Këshilli i Pleqve. Mësimi në të gjitha shkollat do të zhvillohej në gjuhën shqipe. Shqipja do të përdorej, bashkë me turqishten, edhe në shkollat e larta. Gjithë nëpunësit civilë dhe ushtarakë do të ishin Shqiptarë. Ushtria, që do të përbëhej nga Shqiptarët, do të shërbente brenda kufijve të Shqipërisë.

Ashtu si Sami Frashëri, edhe Ismail Qemali mendonte që organizimi shtetëror i Shqipërisë autonome të ishte i tillë, që kur Perandoria Osmane të shturej, Shqipëria të qëndronte në këmbë dhe të dilte prej saj si shtet i pavarur.<sup>1390</sup>

Kërkesave politike të Shqiptarëve rreth lirisë kushtetuese dhe autonomisë, siç ishin ato të shtruar nga Hasan Prishtina në parlamentin turk dhe në gazetën osma-

---

<sup>1388</sup> Po aty.

<sup>1389</sup> Gawrych, George: “Gjysmëhëna dhe shqiponja”, Tiranë, 2007 dhe dhe “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 406.

<sup>1390</sup> Prifti, Kristaq: “*Doktor Ibrahim Temo*”, Prishtinë, 1996, faqe 244-253.



ne me ndikim, dhe të Ismail Qemalit të të botuara në “*La Nazione Albanese*”, në korrik të vitit 1909, qeveria osmane jo vetëm që nuk do t’ua vërë veshin, por do të urdhërojë Xhavit Pashën që të vazhdonte fushatën, të cilën, siç i deklaronte gazetës “*La progres de Salonique*” (Përparimi i Selanikut), ajo kishte për qëllim “*jo më shumë se të likuidonte disa rebelë Shqiptarë*”.<sup>1391</sup>

Megjithatë, Shqiptarët në Stamboll dhe pjesët e tjera edhe më tutje do të vazhdojnë të protestojnë, duke bërë të ditur se rruga që kishin marrë Xhonturqit, në radhë të parë do ta dëmtonte Perandorinë Osmane, meqë ashtu hapeshin të çarat e para për ndërhyrje të fqinjëve të Shqiptarëve ndaj tokave të tyre. Kjo do të theksohet qartë edhe nga një promemorie që do t’i drejtohet ministrit të brendshëm, Talat beu më 21 shtator 1909 nga deputetë shqiptarë dr. Ibrahim Temo (themelues i Komitetit Xhonturk) dhe Zenel Abedini nga Gjilani, ku thuhet se “*Në vend që të përdorni armët kundër tyre – përhapni arsimin dhe zhdukni injorancën*”.<sup>1392</sup>

Me nismën e këtyre deputetëve në Stamboll, në fund të tetorit, do të formohet “*Komiteti nismëtar kombëtar*”, i cili u vu në mbrojtje të rezistencës shqiptare. “*Komiteti*” kërkoi nga qeveria që të ndërpresë fushatën ushtarake dhe t’u kthehet meto-dave për gjetjen e zgjidhjes politike. Ndër masat e propozuara ishin edhe këto:

*-të dërgohej në Shqipërinë e Veriut një komision për të bërë hetimet në vend për shkaqet e ngjarjeve që u parashtruan më lartë;*

*-të gjithë ata që kishin bërë veprime të këqija të dënoheshin sipas ligjeve;*

*-të mos shtrihej në Vilajetet e Shkodrës, të Kosovës e të Manastirit shërbimi i detyrueshëm ushtarak, i cili nuk ka qenë i njohur asnjëherë nga popullsia si dhe të merreshin masa për zhvillimin ekonomik të vendit. Kërkesat u pranuan dhe u nënshkruan nga të gjithë deputetët Shqiptarë.*<sup>1393</sup>

Pas protestave të mëdha, që qeverisjes xhonturke do t’i vijnë nga Shqiptarët, por edhe nga përfaqësuesit e huaj, veçmas nga Austro-Hungarezët dhe Italianët, Stambolli do të kërkojë nga Xhavit Pasha që të bisedojë me Shqiptarët, por me udhëzimet shtesë që të mos hiqej dorë nga rruga e nisur, pra e “vendosijes së rendit”. Ai e bëri këtë me lumjanët, të cilëve u premtoi se do të tërhiqej me kusht që ata t’u nënshtroheshin urdhrave të qeverisë. Kjo megjithatë, nuk e ndryshoi gjendjen, meqë kishte mbetur edhe mëtutje në fuqi kursi i militarist i Xhonturqve të “vënies së rregullit” me anën e dhunës ushtarake në “zonat kryeneçe”. Kjo do të shkaktojë kryengritje të tjera në Vilajetin e Kosovës, të cilat do të përhapen me të

<sup>1391</sup> “*Le Progres de Salonique*”, 20 shtator 1909.

<sup>1392</sup> Prifti, Kristaq: “*Doktor Ibrahim Temo*”, Prishtinë, 1996, faqe 256-258.

<sup>1393</sup> Po aty.

madhe, të cilat qeverisë turke do t'ia bëjnë me dije se me mjete ushtarake, nuk ishte në gjendje *“që Shqiptarët të mbusheshin mend me anën e kërbaçit”*, siç thoshte Mahmut Shefqet Pasha. Ministri i brendshëm, Talat beu, do të detyrohet që të marrë në shqyrtim kërkesën e Shqiptarëve që Xhavit Pasha, jo vetëm të largohet nga Rumelia, por njëherësh edhe të hidhet në gjyq si shkaktar i trazirave Kosovë.<sup>1394</sup>

Dhuna e ushtruar nga Xhavit Pasha dhe nga ushtria osmane mbi Shqiptarët e thelloi edhe më hendekun midis Shqiptarëve dhe Xhonturqve, me çka forcoi tek Shqiptarët bindjen se interesat e tyre si komb ishin krejt të veçanta nga ato të Xhonturqve. Kjo më së miri paraqitej në një korrespondencë të dërguar nga Shkupi dhe të botuar në gazetën *“Dielli”* më 26 nëntor 1909, ku thuhet se:

*“Kombëtaria pati prej sjelljeve të Turqve të rinj një fitim të madh, se pas ngjarjeve të Lumës filloi të gjallërohet edhe më tepër lëvizja kombëtare në Kosovë, u përhapën aq shumë idetë dhe dëshirat për vetëqeverimin e Shqipërisë, sa nuk ishte e mundur kurrë e që as me një propagandë 20-vjeçare nuk do të kishim mundur t'i arrinim”*.<sup>1395</sup>

Gjallërimi i Lëvizjes Kombëtare në Kosovë, që pasqyrohet me ngritjen e rezistencës së armatosur në një shkallë të gjerë, e cila sa vinte dhe bëhej gjithëpërfshirëse, kishte të bënte me kursin armiqësor të Xhonturqve ndaj Shqiptarëve, i cili do të kulmojë me dekretin për mbylljen e shkollave shqipe si dhe mbylljen e klubeve shqiptare të 5 prillit të vitit të vitit 1910, që do të pasojë pas mbajtjes së Kongresit të Dytë të Manastirit, kur Shqiptarët, edhe pas gjithë asaj fushate që do të ndërmerret kundër shkronjave shqipe, do të përcaktohen për atë latin. Kur kësaj i shtohet edhe vazhdimi i fushatës ushtarake e cila do të rikthehet me ekspeditat e Xhavit Pashës, gjithnjë në kërkim të vjeljes së taksave si dhe të vendosjes *“së rendit”*, atëherë pranvera e vitit 1910 nuk mund të ishte tjetër pos një përdezje e re e rezistencës së armatosur kundër qeverisjes së Xhonturqve dhe kursit të tyre kundër Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Që të pengohet ky zhvillim, senatorët dhe deputetët shqiptarë me anën e bisedimeve me Xhonturqit, qeverinë dhe parlamentin, dëshironin të siguronin zhvillimin dhe përparimin e kombit shqiptar dhe ruajtjen e territorit kombëtar. Madje, për këtë qëllim aty nga fundi i vitit 1909 në Stamboll e formuan një ko-mision shqiptar të posaçëm për rregullimin e marrëdhënieve shqiptare. Kjo në fakt, *“ishte një lloj përfaqësie ose qeverisje shqiptare e paemëruar, jozyrtare”*.<sup>1396</sup>

<sup>1394</sup> Prifti, Kristaq: *“Doktor Ibrahim Temo”*, Prishtinë, 1996, faqe 256.

<sup>1395</sup> *“Historia e Popullit Shqiptar”*, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 411.

<sup>1396</sup> Abdyli, Tahir: *“Hasan Prishtina”*, Prishtinë, 2003, faqe 41.

Në atë komision hynë: Sylejman Pasha, senator; Aziz Pasha, deputet i Beratit; Hasan Prishtina, deputet i Prishtinës; Mehmet Pasha, gjeneral dhe Rexhep Efendia, myfti i Manastirit.<sup>1397</sup>

Mirëpo, sa më shumë që thellohej aktiviteti politik dhe diplomatik i parlamentarëve Shqiptarë aq më ashpër sillej Xhavit Pasha ndaj popullatës së Kosovës. Kësaj do t'i ndihmojë padyshim edhe rënia e kabinetit të Hilmi Pashës dhe zëvendësimi me atë të Haki Pashës, ku nuk mori pjesë asnjë shqiptarë. Haki Pasha, qysh në mbledhjen e parë të Këshillit të Ministrave do të promovojë qëndrimin antishqiptar me fjalët:

*“ Rreziku më i madh i Turqisë, nga të gjitha kombet që jetojnë në perandorinë tonë, janë Shqiptarët; është frikë e madhe nga ky të mos zgjohet nga gjumi i rëndë dhe të mos mëkëmbet, të mos marrë diturinë në gjuhën e vet, sepse atëherë e mori lumi Turqinë e Europës ”.*<sup>1398</sup>

Përballë kësaj gjendjeje pakënaqësia e Shqiptarëve e shprehur nëpërmes rezistencës së armatosur do të dalë në pah qysh në ditët e para të pranverës. Shumë të rinj, për t'iu shmangur shërbimit ushtarak, dilnin në mal dhe rebeloheshin, qoftë edhe jashtë ndonjë mbikëqyrje organizative. Kur kësaj i shtoheshin edhe arsytet e tjera, atëherë hendeku midis Shqiptarëve dhe qeverisë xhonturke bëhej gjithnjë e më i përballueshëm.

Kjo gjendje i shkonte për shtati më shumë krahut militant të Xhonturqve të dominuar nga ushtarakët, të cilët kërkonin shkase që ta shtonin edhe më dominimin në politikë. Kështu që nën trysninë e ushtarakëve Sulltan Mehmet Reshati V, i cili shfaqej si një kukull në duart e Komitetit “*Bashkim e Përparim*”, në Kosovë shpalli gjendjen e jashtëzakonshme, me ç'rast urdhërohej të shpërndaheshin sa më parë forcat kryengritëse; të arrestoheshin dhe të nxirreshin para gjykatës ushtarake organizatorët e kryengritjes; të bëhej regjistrimi i popullsisë dhe pasurisë së patundshme; të zbatoheshin shërbimi i detyrueshëm ushtarak; të mblihdeshin me forcë taksat etj. Porta e Lartë urdhëroi Ministrin e Luftës që të përgatiste sa më shpejt ekspeditën ndëshkimore, në krye të së cilës do të vihej Shefqet Turgut Pasha, njëri ndër gjeneralët më të njohur të ushtrisë osmane aso kohe.<sup>1399</sup>

Që t'i bëhej ballë kësaj fushate, disa nga liderët Shqiptarë, kryesisht përkras të Sulltan Hamitit: Isa Boletini, Sulejman Batusha dhe Shaban Binaku, nga mesi i

---

<sup>1397</sup> Po aty, faqe 41.

<sup>1398</sup> Revista “*Leka*”, nr. VIII-XII, Bleni I, Shkodër, 1937, faqe 338, dhe Abdylil Tahir: “*Hasan Prishtina*”, Prishtinë, 2003, faqe 42.

<sup>1399</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 427.

prillit thirrën një kuvend, i cili u mbajt te Verrat e Llukës, në afërsi të Deçanit. Në kuvend nuk pati kërkesa me karakter kombëtar, pos që u lidh besa për mbrojtje të përbashkët, së cilës i parapriu pajtimi për faljen e gjaqeve. Për t’iu bashkuar besës u ftuan edhe pjesët tjera të vilajetit të Kosovës dhe atij të Shkodrës, që kërcënoheshin më së shumti nga fushatat ushtarake. Megjithatë, do të jetë takimi i krerëve shqiptare që do të mbahet në Ferizajt pas pak kohësh, i cili do të vë në lëvizje veprimi shumë nga prijësit e fiseve shqiptare që t’i bashkohen një kryengritje të përgjithshme, e cila do të fillojë nga mesi i majit dhe do të marrë përmasa të rëndësishme.

Sidoqoftë, ishin deputetët shqiptarë (13 nga 26 sosh) në Parlamentin Osman, të cilët me paraqitjen e një relacioni për gjendjen e vështirë të krijuar në Shqipëri, veçmas në Vilajetin e Kosovës, si rrjedhim i politikës nacionaliste të Komitetit “*Bashkim dhe Përparim*”, kërkonin të parandalonin përshkallëzimin e këtij konflikti, të cilin Xhonturqit tashmë e kishin paraparë dhe e dëshironin me çdo kusht për ta dëshmuar kursin e tyre militarist. Në deklaratën që deputeti i Kosovës, Nexhip Draga, bëri më 10 prill në emër të grupit të deputetëve shqiptarë e quajti të padrejtë dhe e dënoi vendimin e qeverisë për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në vilajetin e Kosovës. Ismail Qemali, Myfit Libohova dhe deputetë të tjerë shqiptarë sollën dëshmi me të cilat bëhej e ditur se ngjarjet në Kosovë ishin pasojë e administrimit të keq të vendit, e sjelljeve arbitrare të nëpunësve vendorë, si dhe e karakterit anakronik të mënyrës së qeverisjes që zbatonin Xhonturqit.<sup>1400</sup>

Ngjashëm do të shprehet edhe Hasan Prishtina gjatë një polemike që kishte në parlament me kryeministrin Haki Pasha, të cilit do t’i drejtohet me fjalët se “*në qoftë se një ditë do të vendoset në këtë vend nga një regjim me të vërtetë kushtetues, ju do të dilni para gjykatës së lartë*”. Pasi që kërkoi shpërndarjen e kabinetit të Haki Pashës, Hasan Prishtina do të tërheqë vërejtjen me brengosje:

*“Mos harroni se vendi po rrokulliset me shpejtësi të rrufeshme në vorbullën e fatkeqësisë dhe se kjo ditë është një ditë provimi për përfaqësuesit e popullit”*.<sup>1401</sup>

Për Xhonturqit rrokullisja drejt fatkeqësisë për të cilën tërhiqte vërejtjen Hasan Prishtina, nuk kishte të bënte me gjetjen e gjuhës së përbashkët me Shqiptarët, por për të kundërtën. Pra, që atyre t’u bëhej me dije, natyrisht me anën e përdorimit të dhunës ushtarake, pranimi i kursit të qeverisë “*për vendosjen e rendit*”.

Nënshtrimi i rezistencës së Shqiptarëve me masa ushtarake kishte të bënte edhe me porosinë e qartë që duhej të merrnin krerët e Lëvizjes Kombëtare Shqip-

<sup>1400</sup> Po aty, faqe 429.

<sup>1401</sup> Hasan Prishtina: “*Dokumente*” (Nga procesverbali në parlament), faqe 38-39, dhe Abdyli, Tahir: “*Hasan Prishtina*”, Prishtinë, 2003, faqe 48.

tare të përfshirë në institucionet parlamentare dhe shtetërore që të hiqnin dorë nga kërkesat e tyre të njohura për autonomi, të cilat tashmë shtroheshin në rrugë parlamentare dhe e vetmja mënyrë që ato të mos përfillehin ishte mbajtja e Shqiptarëve në një gjendje të nderë.

Me këto pretendime do të shfaqet në kryeqendrën e Vilajetit të Kosovës, në Shkup, gjeneral Turgut Pasha, me porosinë se ishte aty jo për të shkaktuar gjakderdhje, siç akuzohej nga disa prej deputetëve Shqiptarë dhe një pjesë e shtypit të brendshëm dhe atij të jashtëm, por për të vendosur rregullin dhe qetësinë dhe për të ndëshkuar të gjithë ata që mbillnin përçarje. Ai deklaronte se qeveria dëshironte t'i siguronte popullit shqiptar të mirat e rendit kushtetues, prandaj ishte në interesin e tij dhe të shtetit që të gjithë kryengritësit të dorëzoheshin.<sup>1402</sup>

Kryengritësit shqiptarë, të tubuar në tri pjesë dhe nën udhëheqjen e tre feudalëve vendorë: Isa Boletini, Hasan Hysen Budakovës dhe Idriz Seferit, pa përfillur kërkesën e Turgut Pashës që të dorëzoheshin, vazhduan të vepronin në tri drejtime. Isa Boletini, duke u përqendruar te gryka e Carralevës dhe vija Ferizaj-Shtimje-Prizren; Hasan Hysen Budakova në pjesën perëndimore te Ferizajt deri te Carraleva dhe Idriz Seferi në mbrojtje te grykës së Kaçanikut dhe të mbronte rrugën Tetovë-Shkup.

Fillimisht ushtria osmane, do të testojë forcat shqiptare me anën e lëvizjeve të matura në drejtim të tyre, pa pretendimet e ndonjë ofensivë të madhe, ani pse nga një pjesë e madhe e historianëve shqiptarë ajo do të vlerësohet ndryshe, sikur të ishte fjala për diçka të tillë, ndonëse faktet flasin për të kundërtën.<sup>1403</sup>

Nga mesi i prillit dhe deri në fund të tij, komanda e forcave osmane të përqendruara në rrethinën e Shkupit, hodhën në veprim formacione të vogla, të cilat nuk ia dolën që të dobësojnë mbrojtjen shqiptare përgjatë grykës së Kaçanikut. Në ditën e fundit të prillit, pasi që të ketë krijuar një pasqyrë të plotë rreth përqendrimit të kryengritësve shqiptarë dhe kur do të bindet se prijësit e rezistencës nuk e kanë ndërmend të dorëzohen, Turgut Pasha filloi sulmin në drejtim të Kaçanikut

---

<sup>1402</sup> Abdylil, Tahir: "*Hasan Prishtina*", Prishtinë, 2003, faqe 48-50 dhe "*Historia e Popullit Shqiptar*", vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 427.

<sup>1403</sup> Shih "*Historia e popullit shqiptar*", vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 429-438, ku në një rën anë rezistenca e armatosur e Kosovës ndaj fushatës ushtarake të Shefqet Turgut Pashës paraqitet si një luftë e përmasave të mëdha, ku morën pjesë mbi 70 mijë ushtarë osmanë bashkë me altileri dhe formacione të tjera përcjellëse së cilës do t'u bëjnë ballë Shqiptarët (rreth 20 mijë sish nën armë), ndërsa po në të njëjtin kapitull, kur flitet për shkaqet e disfatës, ajo arsyetohet se nuk kishte një qendër të përgjithshme organizimi në gjithë vilajetin, gjë që ishte e vërtetë, dhe si e tillë, vatrat kryesore të luftës (Kaçaniku dhe Carraleva) mbeti e shkëputur jo vetëm nga vilajetet shqiptare, por edhe nga pjesët e Vilajetit të Kosovës.

me forcat e këmbësisë malore, të ndihmuara nga bateritë e topave, që do të hehthnin predha në pjesën veriore si dhe në katundet përreth.

Ishte kjo një porosi e qartë kryengritësve shqiptarë nga gjenerali osman, se fushata e tij nuk do të ndalej me thyerjen e rezistencës, por për më tepër edhe të rrënimt të bazës materiale, siç ishin katundet dhe prona, mbi të cilën ajo ishte mbështetur dhe do të mund të qëndronte. Forcat e drejtuara nga Idriz Seferi, bënë rezistencë, por pas disa ditësh detyrohen të tërhiqen në drejtim të Karadakut. Kjo ia hapi rrugën depërtimit të trupave osmane në drejtim të Ferizajt dhe të Shtimes, ku do të priten nga kryengritësit e Isa Boletinit, që do të bëjnë përpjekje që ushtrive osmane t'u ndalej depërtimi në drejtim të Carralevës për në Prizren dhe tutje për në Dukagjin.

Nga mesi i majit, kryengritësit e Isa Boletinit, për disa ditë, penguan depërtimin e trupave osmane, por kjo nuk mjaftoi, meqë Turgut Pasha, si ushtarak i shquar, vepronte në përputhje me planin e hartuar që më parë, që kryengritësit Shqiptarë t'i mbante të shkëputur në pjesë të ndryshme, duke i shkallmuar pak, që të detyrohen të tërhiqen dhe në tërheqje e sipër të shkapërderdheshin prej nga pastaj nuk kishin zgjidhje tjetër pos të dorëzoheshin ose të asgjësoheshin.

Në të vërtetë kështu edhe do të ndodhë. Përkundër rezistencës së madhe dhe në çaste heroike që kryengritësit Shqiptarë treguan gjatë muajve prill-qershor në fushëbetet e grykës së Kaçanikut, asaj të Carralevës dhe në Karadak dhe, përkundër humbjeve të ndjeshme që u sollën forcave osmane nga sulmet në befasi, megjithatë, fushata e Shefqet Turgut Pashës, do t'ia ia dalë t'i plotësojë synimet e parapara, pra që nga Kosova, pasi që ta shtrojë atë ushtarakisht, të kalojë në veri (në Shkodër dhe Malësi) dhe prej andej forcat ushtarake të hedhen në Shqipërinë e Mesme dhe në pjesët tjera, ku edhe pse nuk kishte rezistencë, siç ishte ajo e Kosovës, të demonstrohej "vënia e rendit" në vilajetet kryeneçe shqiptare, duke bërë me dije kështu se njëherë e mirë kishte përfunduar koha e "qeverisjeve lokale".

Në rrugë për në Shkodër, terrori xhonturk ishte jashtëzakonisht i ashpër dhe nuk kursente gjë. Madje, disa prita që do t'i bëhen nga banorët e fisit Shosh dhe të Shalës nga bajraktari Mehmet Shpendi, u shërbyen si shkase për hakmarrje të ashpër ndaj këtyre fiseve, të cilat, pasi që do t'i shtrojë, do t'i çarmatosë dhe në kalim e sipër do t'ua rrënojë shumë prej kullave. Kështu do të veprojë ndaj çfarëdo rezistence që do t'i paraqitet deri sa do të hyjë në Shkodër. Prej andej do të largohet pasi që të ketë themeluar gjyqet ushtarake. Pas qëndrimit të shkurtër në Mirditë gjenerali osman iu drejtua Tiranës dhe Elbasanit, ku gjyqet ushtarake dënuan me burgime të gjata shumë veta pse kishin marrë pjesë në veprimtari legale të klubeve shqiptare, ose ishin dalluar gjatë fushatës për përhapjen e shkollës shqipe dhe alfabetit me shkronja latine.

Mbyllja “me sukses” e fushatës ushtarake të Shefqet Turgut Pashës, së pari u përcoll me shfuqizimin që Mahmut Shefqet Pasha do t’ia bëjë Kanunit të Lekë Dukagjinit dhe vendosjen e gjykatave të rregullta për të siguruar rendin dhe sigurinë, cili do të shoqërohet edhe me luftën e ashpër të qeverisë kundër lëvizjes kulturore shqiptare. Krahas vendimit për mbylljen të gjitha shkollave shqipe, pasoi edhe ai për ndalimin e nxjerrjes së gazetave dhe botimit të librave shqipe, me ç’rast filloi një fushatë kundër redaktorëve dhe botuesve të tyre. Duke u akuzuar “si nxitës të revoltës”, u burgosen shumë nga drejtuesit e gazetave kryesore shqiptare.<sup>1404</sup>

Fehmi Zavalani, botues i “*Bashkimit të Kombit*” në Manastir dhe bashkëpunëtorët e tij u arrestuan sepse patën botuar një shkrim ku dokumentoheshin krimet e luftës së ushtrisë Osmane në Kosovë, duke u dokumentuar me të dhëna. Me akuza të tilla u arrestuan edhe redaktorët e gazetave të tjera: Mihail Grameno nga Korça dhe Lef Nosi nga Elbasani.<sup>1405</sup>

Masa të ngjashme u morën edhe ndaj mësuesve të gjuhës shqipe të shkollave shtetërore, si dhe ndaj nëpunësve shqiptarë që kishin marrë pjesë në lëvizjen kulturore arsimore kombëtare. Hoxha Hafiz Alia u dërgua syrgjyn për dhjetë vjet, për të vetmin shkak se pati mësuar fenë myslimane shqip në Normalen e Elbasanit.<sup>1406</sup>

Në kuadër të kësaj fushate nuk u kursyen as deputetët shqiptarë, të cilët u akuzuan si përkrahës të kryengritjes dhe për lidhje të fshehta me kryengritësit.

Shuarja e kryengritjes shqiptare të Kosovës si dhe përmasat e mëdha të terrorit që u ushtrua ndaj popullatës së pambrojtur nxorën në pah dy gjëra, që do të kenë rëndësi për zhvillimet e mëtejshme:

- përcaktimin e Xhonturqve që “rendi” të vendosej me përdorimin e ushtrisë, që do të thoshte *militarizimi i mëtutjeshëm i politikës*, për ç’gjë kishin edhe përkrahjen e jashtme, veçmas të fqinjëve të Shqiptarëve dhe të Ruisisë, dhe

- mosgatishmërinë e Shqiptarëve që asaj t’i kundërvihen edhe me rezistencë të armatosur në shkallë kombëtare, në mënyrë që t’i jepej një përgjigje e përbashkët me çka edhe rrjedha e ngjarjeve do të ishte ndryshe.

Çështja e parë do të ketë rëndësi të veçantë, sepse krahas hapjes së hendekut të papajtueshëm midis Shqiptarëve dhe qeverisjes Xhonturke deri te përmasat e një shkëputjeje përfundimtare midis tyre, në të njëjtën kohë do të qesë në pah faktin se Xhonturqit në këtë udhë, me përjashtim të ndonjë “qortimi” verbal, nuk i kishin kundër Fuqitë e Mëdha dhe as që rrezikonin ndonjë telash me ta pse kishin marrë këtë

<sup>1404</sup> Prifti, Kritaq: “*Doktor Ibrahim Temo*”, Prishtinë, 1996, faqe 266.

<sup>1405</sup> Shih HHStA, PA XIV/24, Albanien.

<sup>1406</sup> Po aty.

rrugë. Për këtë, madje, do të marrin përkrahjen e fqinjëve të Shqiptarëve (Serbëve, Bullgarëve dhe Grekëve) dhe të Rosisë. Kjo e fundit, qeverisë osmane i dha disa fonde të veçanta materiale, që të zbatohet sa më me përpikëri “reformat” në vilajetin e Kosovës, ndër të cilat për rusët ishte me rëndësi çarmatosja e Shqiptarëve dhe rrëni-mi i çfarëdo bërthame të rezistencës së armatosur e cila do të lidhej me kërkesa politike.

Bie në sy sjellja dyfytyrëshe e fqinjëve të Shqiptarëve, në radhë të parë e Serbëve dhe Malaziasve, të cilët, në njërin anë për t’i nxitur feudalët shqiptarë, veçmas Isa Boletinin me të cilin mbanin lidhje të mira, për rezistencë të armatosur, duke u dhënë armë dhe mjete të tjera materiale, ndërsa në tjetrën anë, diplomacia serbe si dhe qeveria e Beogradit, me anën e kanaleve të drejtpërdrejta, nga Porta e Lartë kërkonte pikërisht që të qërohen hesapet me “banditët arnautë” në mënyrën më të ashpër dhe këtë kërkesë do ta kthejnë në “masë” të forcimit të besimit.

Të ashtuquajturat “Këshilla kombëtare serbe” nëpër disa pjesë të Kosovës, dhe klerikët serbë që shërbenin në manastiret ortodokse, merrnin udhëzime nga Beogradi që të bashkëpunojnë ngushtë me qeveritarët osmanë dhe agjentët e tyre ushtarakë, duke u dhënë informata për kryengritësit Shqiptarë dhe lëvizjet e tyre, pa përjashtuar këtu hollësi, të cilat për shumë prej tyre do të jenë fatale.<sup>1407</sup>

Edhe çështja e dytë, pra mosgatishmëria që rezistenca e armatosur të zhvillohet në shkallë kombëtare dhe të ndërlihet me qëllime të qarta politike, do t’ua bëjë me dije liderëve të lëvizjes kombëtare shqiptare se në rrethanat në të cilat gjendeshin, planet politike dhe parlamentarizmi mund të ktheheshin në një farsë pa mundësinë e trysnisë që do t’i bëhej asaj me anën e lëvizjeve gjithëkombëtare, të ndërlihur dhe bashkëvepruese në çdo kohë dhe me shpërndarje të njëjtë në të gjithë hapësirën etnike shqiptare.

Rasti i lënies së kryengritjes në Kosovë kundër politikës shtypëse të qeverisë xhonturke në duart e disa liderëve vendorë (kryesisht feudalë, të cilët kishin namin e përkrahësve të Sulltan Hamitit), dëshmon se disa nga deputetët shqiptarë, të cilët kishin zënë vendet në Parlamentin Osman dhe mandatin e kishin fituar si kandidatë të Komitetit “*Bashkim dhe Përparim*”, nuk do të brengosen gjithaq për rrënimin e fuqisë së feudalëve të Kosovës në konfrontim me Xhonturqit, po qe se kjo lidhej me interesat e tyre personale, ani pse kjo njëherësh paraqiste dobësim politik të çështjes

---

<sup>1407</sup> Rreth çështjes së bashkëpunimit të Serbëve të Kosovës me pushtetin osman në Kosovë, veçmas gjatë kryengritjes së vitit 1910 shih Perunović Branko: “*Pisma srpskih konsula iz Pristine*”, Beograd, 1985; Abdyl, Tahir: “*Hasan Prishtina në lëvizjen kombëtare demokratike 1908-1933*”, Prishtinë, 2003; Cana, Zekeria: “*Lëvizja kombëtare shqiptare në Kosovë 1908-1912*”, Prishtinë, 1979; Radovanović R. Milan: “*Sokolsko društvo u Prištini od 1909-1912*”, 1969; Hađzi-Vasiljević Jovan: “*Četnička akcija u Staroj Srbiji i Makedoniji*”, Beograd, 1928.



shqiptare. Mjafton të përmendet konflikti i interesave midis Isa Boletinit me Nexhip Dragën rreth çështjes së koncesioneve të pyjeve në veri të Kosovës dhe të ndërtimit të një sharre të re me avull, të cilat ky i dyti do t'i fitojë nga qeverisja xhonturke, por që kundërshtoheshin nga “tapitë” e të parit, që ai i kishte nga Sulltani.<sup>1408</sup>

Dhe dobësimi i parë politik i Shqiptarëve pas ardhjes në pushtet të Xhonturqve do të shënohet pikërisht pas përfundimit të fushatës ushtarake të Turgut Pashës në Kosovë dhe pjesët tjera të Shqipërisë gjatë pranverës dhe verës së vitit 1910. Me këtë rast, qendra kryesore e fuqisë shqiptare, e cila Xhonturqit i kishte sjellë në pushtet para dy vitesh, jo vetëm që kishte humbur fuqinë e vet rezistuese, por ajo rrezikonte të shkapërderdhej në pjesë të ndryshme në drejtim të Malit të Zi dhe të Serbisë dhe të kthehej në pre të kundërshtarëve më të mëdhenj të tyre.

Këto vende, të cilat ishin të interesuara për një gjë të tillë, nuk reshtnin së punuari që shqiptarët t'i mbajnë të përçarë midis veti, por njëherësh edhe në konflikt me Perandorinë Osmane, ku ata do të shpenzonin fuqinë e tyre rezistuese jashtë ndonjë plani të përbashkët politik me platformë kombëtare. Kështu ndodhi që pas disfatës së pësuar nga forcat osmane gjatë muajve qershor dhe korrik të atij viti, Serbia, e cila në mënyra të ndryshme kishte nxitur kryengritjen e Kosovës dhe u kishte premtuar ndihmë të gjithanshme drejtuesve të saj, pas gjithë asaj që do të ndodhë, pranoi të strehonte vetëm një pjesë të vogël të kryengritësve, kryesisht udhëheqësit e tyre (Hysen Budakovën, Zejnel beun nga Gjilani, Shaqir Çavdarbashën nga Peja dhe bajraktarin e Ostrozubit). Ndërsa, kryengritësit e anës veriperëndimore të Kosovës, në fillim u vendosën në Bjeshkët e Nemuna, por pasi që të fillojë të ftohtit dhe do t'u mungojë ushqimi, do të kërkojnë të kalojnë në Mal të Zi.

Isa Boletini kërkoi ndihmë nga Cetina që të strehohej atje bashkë me bashkëluftëtarët dhe familjet e tyre. Kërkesa e Boletinit u pranua nga ana e Malit të Zi. Ata u vendosën në Cetinë, në Podgoricë, në Shpuzë, në Nikshiq dhe në Ulqin.<sup>1409</sup>

Bashkë me Isa Boletinin në Mal të Zi strehim gjetën edhe prijës të tjerë të kryengritjes së vitit 1910, si Dedë Gjo Luli, Mehmet Shpendi, Sulejman Batusha, Mirash Ndou e të tjerë nga Malësia e Shkodrës, të cilët po ashtu do të përfshihen në rezistencën kundër Turgut Pashës, por pasi që ai të ketë shtruar Kosovën do t'i drejtohej Veriut, që edhe atje të “vente rregull” me anën e forcës ushtarake. Sipas deklaratave të qeverisë malazeze, në territorin e saj ndodheshin më 1910 rreth 800 familje shqiptare me afër 3000 veta. Kjo shifër shpejt do të dyfishohet, ngaqë auto-

---

<sup>1408</sup> Më gjerësisht rreth konfliktit të interesave midis familjes Boletini dhe Draga shih te Gawrych,George: “Gjysmëhëna dhe shqiponja”, Tiranë, 2007,faqe 246-248.

<sup>1409</sup> “Historia e Popullit Shqiptar”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 438.

ritetet osmane vazhduan veprimet “pastruese” në shumë pjesë të Kosovës dhe të Veriut, që për pasojë kishte largimin e popullatës nga trojet e tyre.<sup>1410</sup>

Mbreti Nikollë strehimin e Shqiptarëve do ta arsyetojë me qëllime humanitare, por si do të shihet, Cetina bënte çmos që këtë ta shfrytëzojë që të arrijë edhe qëllime politike, që dolën në pah pak më vonë, kur kërkoi që Shqiptarët e Veriut, veçmas fiset katolike nga mbi Shkodra të hidheshin në një kryengritje kundër Perandorisë Osmane.

Kjo kryengritje për Cetinën kishte rëndësi, sepse ia përgatiste kushtet që edhe Mali i Zi të përfshihej në këtë luftë prej nga do të nxirrte përfitime mbi tokat shqiptare, të cilave ua kishte vu syrin që t’i aneksonte. Edhe pse Rusia e këshillonte që të mos nxitonte t’i përdorte Shqiptarët për këto qëllime nga shkakut se në të mund t’u fusnin gishtat edhe faktorët tjetër (austro-hungarezët dhe italianët, po edhe serbët), mbreti Nikollë gjeti mënyrë që kryengritjen ta nxiste me anën e vetë Shqiptarëve. Fjala ishte për disa bashkëpunëtorë të Malit të Zi nga radhët e Shqiptarëve të cilët prej kohësh kishin lidhje me Cetinën dhe ajo i mbante pranë. Ata bënë thirrje për luftë dhe premtonin se për këtë kishin ndihmën e Cetinës.

Por, nuk ishin vetëm Malaziasit me bashkëpunëtorët e tyre që në ato çastet të vështira për Kosovën dhe Veriun kërkonin veprime luftarake dhe kryengritje të armatosur. Komitete të ndryshme të themeluara prej kohësh në Itali, Rumani, Bullgari, Greqi dhe vende të tjera, ku ishte e përqendruar diaspora shqiptare dhe mërgata, u vunë në veprim në kërkim të organizimi të një kryengritjeje, e cila do të fillonte në Veri, por shpejt do të duhej të përfshinte edhe Mesin dhe Jugun e Shqipërisë.

Njëri ndër këto komitete, që kishte pretendime të merrte përsipër bashkëveprimin me komitete të tjera jashtë vendit, ishte ai i Barit, i formuar nga Nikollë Ivanaj. Ivanaj iu vu punës që thirrjen e kryengritjes ta bënte nga jashtë në Shqipëri, duke premtuar armë si dhe mbikëqyrje tjetër. Komiteti i Barit sigurisht se do të trimërohet nga formimi në Itali i Komitetit “*Pro Albania*”, rreth të cilit u bashkuan republikanë, socialistë, demokratë dhe të tjerë, të cilët ishin të interesuar që në Shqipëri të krijohet një lëvizje proitaliane, e cila do t’ua ndalte pretendimet Austro-Hungarisë dhe vendeve fqinje.<sup>1411</sup>

Kjo frymë “proshqiptare”, e cila si do të shihet drejtohej nga interesa të caktuara politike italiane, ndikoi që shumë nga Arbëreshët të përfshihen në të, duke shprehur gatishmërinë që të shkonin si vullnetarë për të luftuar në Shqipëri.

---

<sup>1410</sup> Po aty.

<sup>1411</sup> Raport i fshehtë drejtuar Aehrenthalit nga Giesl, faqe 12 HHStA, PA XIV/28, Albanien XX/10.

Çështja e vullnetarëve italianë në Shqipëri tashmë ishte bërë publike dhe ishte kthyer në një fushatë të madhe, meqë ajo planifikohej të drejtohej nga i biri i Xhuzeppe Garibaldit, Riçioti Garibaldi (Ricciotti Garibaldi), i cili kishte shpallur edhe “hollësi” të tjera rreth kësaj ekspedite, e cila kishte për qëllim që të përhapte flakën e kryengritjes atniosmane në Shqipëri. Por, i biri i gjeneral Garibaldit hoqi dorë nga aventura shqiptare çastin që Italia po përgatitjet për të sulmuan Tripolin.

Në këto rrethana, kur Shqiptarët e Kosovës dhe të pjesëve veriore morën një grusht të fortë nga ekspedita e Turgut Pashës dhe shumë prej tyre do të detyrohen që të kërkojnë strehim në Mal të Zi dhe prej andej ndaj tyre do të zhvillohet trysni nga anë të ndryshme që të vazhdonin luftën, edhe pse rrethanat për këtë ishin shumë të papërshtatshme, Austro-Hungaria dhe Britania e Madhe kërkuan nga Porta e Lartë që të ndiqte një politikë pajtuese me Shqiptarët dhe t’ua plotësonte disa nga kushtet. Ndër ato kushte më të rëndësishmit ishin ato që lidheshin me krijimin e rrethanave për t’u kthyer në shtëpitë e tyre.

Vjena, e cila nuk ishte e interesuar që Shqiptarët të instrumentalizoheshin për qëllimet e Malit të Zi apo të Italisë dhe të Serbisë, ia tërhoq vërejtjen Cetinës që të mos luajë me Shqiptarët dhe vështirësitë e tyre për qëllime politike. Vjena madje, me anën e përfaqësuesve të vetë diplomatik në Stamboll, por edhe të konsujve në Shkodër, Shkup dhe Manastir, bisedoi me shumë nga deputetet shqiptarë në Stamboll si dhe me përfaqësuesit e parisë në Kosovë dhe Shkodër, që të heqin dorë, si thuhej, nga “futja në aventura të huaja” dhe t’u kthehen bisedimeve me Portën e Lartë që çështjet të zgjidhen me anën e marrëveshjeve, sepse kryengritjet dhe lufta do t’u sillte edhe më shumë vështirësi. Porosia që do t’u jepet Shqiptarëve ishte e qartë: me dobësimin e Kosovës ata shihnin forcimin e pansllavizmit.<sup>1412</sup>

E shtyrë edhe nga trysnia ndërkombëtare dhe rreziku që kryengritja e Shqiptarëve të Kosovës dhe atyre të Veriut do të mund të shfrytëzohej nga Vjena për ndonjë veprim politik po edhe ushtarak që do të dëmtonte planet malaziase, Cetina, së paku sa për sy e faqe, u detyrua që të marrë rolin ndërmjetësuese tek Porta e Lartë për t’i rikthyer Shqiptarët në trojet e tyre prej nga ata ishin larguar gjatë fushatës ushtarake të Tërgut Pashës. Mbreti Nikollë ndërhyri te përfaqësuesi i Perandorisë Osmane në Cetinë, Sadedin beu dhe te refugjatët Shqiptarë për të gjetur një zgjidhje. Shqiptarët parashtruan këto kushte:

- 1) kthimin e armëve që u kishin marrë;
- 2) lirimin nga taksat që u kishin vënë së fundit dhe

---

<sup>1412</sup> Po aty.

3) ndërtimin e rrugëve dhe çeljen e shkollave kombëtare.<sup>1413</sup>

Përfaqësuesi osman i quajti këto kërkesat tepër të papranueshme dhe këshilloi qeverinë e tij që emigrantët të lireshin në fatin e tyre, “përderisa të mbusheshin mend”, gjë që kështu edhe do të ndodhë. Por, kjo do të ashpërsojë edhe më gjendjen, meqë në Mal të Zi do të derdhën gjithnjë e më shumë Shqiptarë të përndjekur, të cilët kërkonin strehim në këtë vend. Kështu që numri i tyre brenda pak kohësh u dyfishua dhe kjo po i bënte telashe edhe Cetinës, e cila zuri të ankohej se nuk ishte në gjendje që të përballonte fluksin aq të madh të Shqiptarëve. Në pamundësi që ata t’i drejtonte në kryengritje kundër Perandorisë Osmane, meqë këtë ia kishte ndaluar Rusia dhe Serbia, mbreti Nikollë mori përsipër rolin e një “paqebërësi”. Thirri katërmëdhjetë bajraktarët e malësorëve shqiptarë, me të cilët bisedoi për kushtet e kthimit. Ata formuluan kërkesat e tyre në shtatë pikë:

1) Një amnisti e përgjithshme duhej të shpallej me anën e një *iradije*;

2) Shërbimi ushtarak të kryhej vetëm në vilajet – përjashta të kryhej vetëm kur do të sanksionohej prej Stambollit;

3) *Myderrizët* (kryetarët e bashkive) e fiseve duhej të zgjidheshin prej Shqiptarëve;

4) *Kajmekamët* (nënprefektët) duhej të ishin të krishterë të dinin gjuhën shqipe;

5) Vlera e armëve të konfiskuara të kompenzohej dhe, po të armatoseshin mys-limanët, do të armatoseshin edhe të krishterët;

6) Pronat e sekuestruara ose të konfiskuara duhej të zhdëmtoheshin dhe

7) Gjithë pikat e lartpërmendura duhej të zbatoheshin për gjithë malësorët.<sup>1414</sup>

Përfaqësuesi i qeverisë osmane në përgjithësi i gjeti kërkesat të pranueshme dhe ia rekomandoi Portës. Më 18 nëntor 1910, arriti përgjigja e qeverisë osmane që pranonte në përgjithësi kërkesat e Shqiptarëve. Pati vetëm pak ndryshime në hollësi: nuk do të paguheshin para për armë, por shtëpitë e djegura do të dëmshpërbleheshin. Pas komunikimit të notës drejtuar qeverisë malazeze, mbreti Nikollë mblodhi krerët Shqiptarë dhe ua bëri të ditur brendinë e saj. Porositi malësorët që të ktheheshin së bashku me njerëzit e tyre në shtëpitë e veta. Valiu i Shkodrës, Bedri Pasha, do t’i priste në Tuz dhe do të rregullonte kthimin e tyre.<sup>1415</sup>

Kur dukej se pas kthimit të një numri të refugjatëve gjendja në Kosovë dhe në veri do të qetësohej, në Shkodër do të plasë serish konflikti midis malësorëve

<sup>1413</sup> Skëndi, Stavro: “Zgjidhja kombëtare shqiptare”, Tiranë, 2000, faqe 370.

<sup>1414</sup> Telegram i shifruar drejtuar Ritter von Zambaurit në Shkodër, Vjenë 19 nëntor 1910, ora 7 e 30. P.m., HHStA, PA XIV/33, Albanien XXXIV.

<sup>1415</sup> Shih letrën e besueshme Giesel drejtuar Aehrenthalit, Cetinë, 20 nëntor 1910, nr. 102, dhe - Stavri, Skëndo: “Zgjidhja kombëtare shqiptare”, Tiranë, 2000, faqe 372.

shqiptarë dhe ushtrisë osmane. Në mars të vitit 1911, në malet në veri të Shkodrës (Mbishkodra), Dedë Gjo Luli dhe burrat e tij sulmuan postat kufitare turke gjatë kufirit shqiptaro-malazez.<sup>1416</sup>

Para se të ndodhte kjo kryengritje në Veri, duhet thënë se një pjesë e refugjatëve shqiptarë të cilët nuk do të pranojnë që të kthehen në trojet e tyre prej nga ishin larguar, meqë kishin bindjen se qeveria turke do t'i mashtronte, siç kishte vepruar edhe kohë më parë, formuan Komitetin e tyre në Podgoricë, i cili mernte përsipër përkujdesjen për ta, por njëherësh shqyrtonte mundësinë e organizimit të një lufte të armatosur. Komiteti u ndihmua edhe nga atdhetarët shqiptarë që gjen-deshin në Mal të Zi, si Risto Siliqi etj., si edhe nga Nikollë Ivanaj, Hilë Mosi, Luigj Gurakuqi etj., që shkuan më pas në Podgoricë.

Komiteti i Podgoricës u përpoq të shfrytëzonte ndihmën e qeverisë malazeze, por duke bërë përpjekje që sa më pak që të ishte e mundur të binte në kurthin e politikës së saj, sado që kjo nuk ishte e lehtë të arrihej, ngaqë në krye të Komitetit, “*për arsye taktike*”, ishte vënë Sokol Baci, i njohur si njeri i kral Nikollës.<sup>1417</sup>

Sjellja “*taktike*” e Komitetit të Podgoricës ndaj Malit të Zi, megjithatë, nuk do t'i shpëtojë shqiptarët nga vënia nën mbikëqyrje të Cetinës dhe planeve të saj që kryengritja shqiptare të fillojë pikërisht siç e donte: e parakohshme, të jetë lokale dhe të fillojë kryesisht nga fiset shqiptare katolike, në mënyrë që qysh në nismë ajo të paraqesë fitilin e përcarjes së brendshme shqiptare mbi baza fetare, gjë që edhe do të ndodhë.

Kështu, kryengritjes së malësorëve të Hotit të udhëhequr nga Dedë Gjo Luli, Gjek Marash Gjeloshi e të tjerë, Valiu i Shkodrës, Bedri Pasha do t'i kundërpërgjigjet me mobilizimin e shqiptarëve myslimanë, të cilëve do t'u parashtrohet rreziku i një lidhjeje “*katolike-malaziase*” kundër Shqipërisë.<sup>1418</sup>

Edhe pa u pritur zbarkimi i njësisive të Shefqet Tërgut Pashës, që tashmë ishin nisur me anije nga Selaniku dhe priteshin brenda pak ditësh të futeshin në veprime ushtarake, të ngjashme me ato të vitit të kaluar, me anën e të cilave ia kishte dalët të paqësonte Kosovën dhe veriun, njësitë e përbashkëta osmane të përforcuara edhe me vullnetarë shqiptarë muslimanë do të drejtohen në pjesën veriore të kufirit të banuara me popullatë shqiptare të besimit katolik, gjë që e gjitha i gjasonte filli-

---

<sup>1416</sup> Raport i Zambaut drejtuar Aehrenhaltit, Shkodër 27 mars 1911, nr 27. HHStA, PA XIV/33, Albanien,XXXIV.

<sup>1417</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 443.

<sup>1418</sup> Raport i Zambaut drejtuar Aerenhaltit, Shkodër, 27 mars 1911, nr. 24, HHStA, PA IV/33, Albanien, XXXIV.

mit të një lufte të brendshme shqiptare mbi baza fetare nga e cila deri më atëherë ishte kursyer Shkodra.

Që t'i ikej këtij rreziku, i cili ishte i qartë, më 30 mars në Cetinë, u mbledhën disa nga udhëheqësit e kryengritjes, me ç'rast u miratua një memorandum drejtuar Fuqive të Mëdha. Me të kërkohej:

- paprekshmëria e territoreve shqiptare;
- të njihej gjuha shqipe si gjuhë zyrtare në të katër vilajetet, në zyra e gjyqe dhe si gjuhë mësimi në sholla;
- të gjithë nëpunësit në Shqipëri të ishin Shqiptarë dhe të njihej zyrtarisht kombësia shqiptare;
- të ardhurat buxhetore të shpenzoheshin në dobi të vendit;
- ushtarët Shqiptarë të mos shërbenin jashtë trojeve shqiptare.

Memorandumi ishte nënshkruar nga Muharrem Bushati, Isa Boletini, Sokol Baci, Dedë Gjo Luli, Abdullah aga, Preng Kola dhe Mehmet Shendi dhe ka gjasa që të jetë shkruar me ndihmën e ndonjë emisari austro-hungarez, nga ata që Vjena kishte infiltruar tashmë te Shqiptarët që të mos lejonin që kryengritjet e tyre të binin nën ndikimin e plotë të Malit të Zi, ose të Italisë, e aq më pak që ato të ktheheshin në një luftë mbi baza fetare.<sup>1419</sup>

Krahas ndikimit malazias, kryengritja e Malësisë së Veriut, nuk do të mund t'i shpëtonte as atij italian. Madje, në një mision të drejtpërdrejtë në të do të paraqitet edhe dr. Terence Toçi (Tocci), një avokat nationalist italo-arbëresh. Më 27 prill 1911, pas një vizite që ua bëri udhëheqësve kryengritës në Podgoricë, Toçi mbledhi krerët e Mirditës e të Dukagjinit, sikundër edhe myslimanët e Matit dhe të Dib-rës, dhe ngriti flamurin e Shqipërisë në Kimëz (Gimis), në Mirditë. Toçi ishte në marrëveshje me komitetin e gjeneralit Ricciotti Garibaldi, i cili i kishte premtuar ta ndihmonte. Ditën e mbledhjes së bërë në Kimëz, Shqipëria u shpall “e lirë dhe e pranuar më kufijtë e saj në histori dhe gjuhë dhe kombësi”. Aty shpall një qeveri jetëshkurtër “provizore e Shqipërisë” me dr. Toçin si president.<sup>1420</sup>

Duke parë përmasat përherë në rritje të kryengritjes shqiptare si dhe mundësitë po ashtu gjithnjë e më të mëdha të futjes së gishtave të faktorëve të jashtëm (Malit të Zi, Italisë – siç ishte rasti i dr. Toçit kur ai do të shpallë edhe pavarësinë e Shqipërisë, pa marrë parasysh se e gjitha dukej një aventurë provokuese nga jashtë), Porta e

<sup>1419</sup> Po aty.

<sup>1420</sup> Më gjerësisht shih: P. Pal Dodaj: “*Shqybnija e Shqyptarve e Qeverisë së Përkohshme*”, *Hylli i Dritës*, Shkodër, X, (1934), 245-255; *Leka*, op.cit. faqe 514-515 (teksti i deklaratës është i përfshirë); C. Libardi, op. cit., II, 37-49, 52-53; Krajewski drejtur Grupit, Shkodër, 4 qershor 1911, nr. 99. AMAE, Turquie, Politique Interieure, Albanie, janar-qershor 1911, vol IX.

Lartë prapë do t'u kthehet masave ushtarake. Ngarkoi Shefqet Turgut Pashën, i cili nga fundi i prillit zbarkoi në Shën Gjini. Bashkë me të erdhi edhe Preng Bibë Doda, i thirrur nga Vjena prej Xhonturqve për të penguar Mirditën që të përfshihej në një kryengritje e cila mund të kishte prapa interesat malaziasë ose ato italiane.

Kryengritësit Shqiptarë e pritën zbarkimin e gjeneralit osman me anën e një proklamate të publikuar më 1 maj 1911, të shkruar në shqip, frëngjisht, gjermanisht e italisht, ku shpalosej një program autonomist. Në deklaratë kërkohej:

- 1) Shqipëria të bëhej vetëqeveritare me sigurim të qeverive të mëdha nën hijen e Turqisë;
- 2) Shkollat shqipe të mbaheshin prej qeverisë;
- 3) Ushtarët shqiptarë të mos dilnin jashtë kufijve të Shqipërisë, përveç në rast lufte.<sup>1421</sup>

Kryengritja e Veriut ngjalli frymën luftarake edhe jashtë vendit, veçmas në radhët e mërgatës shqiptare në Amerikë, e cila gjithnjë e më shumë ngrinte zërin në mbrojtje të çështjes shqiptare, në rastin konkret ajo përkufizohej me kërkesën e autonomisë brenda Perandorisë Osmane. Fan S. Noli dhe klubet shqiptare u përpoqën që fryma dhe kërkesat e kryengritjes së veriut të barteshin edhe në jug të Shqipërisë dhe ato të artikuloreshin edhe prej andej. Noli madje mori një nismë për të siguruar përkrahjen e Greqisë, por Athina, si edhe herëve të tjera, nguli këmbë që kryengritjet shqiptare mund të zhvilloheshin vetëm deri te lumi Shkumbin!<sup>1422</sup>

Edhe përkundër qëndrimit të tillë të Athinës, gjatë muajit maj, patriotë shqiptarë të tubuar në Korfuz, si Nikollë Ivanaj, Themistokli Gërmenji, Ismail Qemali, Pandeli Cale, Stefan Kondillari, Spiro Bellkameni e të tjerë, krijuan një degë të Komitetit shqiptar të Barit. Ndërkaq që u shtuan përpjekjet për organizimin e kryengritjes në Shqipërinë e Jugut.<sup>1423</sup>

Në maj, pikërisht ditën e nëntë të muajit, Shefqet Turgut Pasha, publikoi shpalljen, ku thuhej se udhëheqësit e kryengritjes do t'i jepeshin gjyqit ushtarak, ndërsa ata që do të dorëzoheshin brenda pesë ditëve, duke dhënë armët dhe duke iu nënshtruar ligjeve e urdhrave të qeverisë, do të përfitonin nga mëshira e saj. Në shpallje thuhej se, po të qëllohej kundër ushtarëve, do të dënohej së bashku me fajtorin edhe pleqësia e katundit. Pasi që të ketë pritur katër ditë, gjenerali osmanë, filloi fushatën ushtarake në drejtim të Deçiqit, duke i marrë pozitat që kohë më parë i mbanin kryengritësit shqiptarë.

<sup>1421</sup> "Historia e popullit shqiptar", vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 446.

<sup>1422</sup> Po aty, faqe 447.

<sup>1423</sup> Po aty, faqe 447.

Forcat osmane u vendosen në vijën Tuz-Deçiq-Kastrat. Po ashtu në drejtim të Gucisë vijonte të ushtronte trysni një forcë tjetër osmane, e drejtuar nga Ethem Pasha. Kjo bëri që numri i Shqiptarëve të zhvendosur nga vatrat e tyre, që kalonte në Mal të Zi të ishte gjithnjë e më i madh, gjë që shtonte varësinë e tyre ndaj këtij vendi, i cili ishte i interesuar që gjatë kësaj lufte Shqiptarët në njërën anë të humbnin sa më shumë fuqinë e tyre luftarake dhe në tjetrën anë, si refugjatë, të binin nën ndikimin e Cetinës, në mënyrë që ajo prej tyre të shihej jo vetëm “si shpëtimtare”, por edhe “mbrojtëse” e njëmendët. Kjo çështje lidhej me planet e Malit të Zi t’i aneksonte viset veriore shqiptare, ose që të krijonte një “principatë” shqiptare brenda mbretërisë malazeze, nën kurorën e të birit Mirkos.<sup>1424</sup>

Dobësimi i faktorit shqiptar në veri, veçmas i popullatës me besim katolik dhe mundësitë që ajo të manipulohej nga Cetina, siç kishte filluar të ndodhte, shtynë Austro-Hungarinë që të ndërhyjë te Porta e Lartë të ndryshonte sjelljen ndaj Shqiptarëve në mënyrë që masat që merreshin për të “vu rregull” të mos ktheheshin në shkase që ata të bëheshin “plaçkë e lehtë” për të tjerët. Këtu mendohej, te ndikimi që Mali i Zi bënte te Shqiptarët në ato rrethana kur një pjesë e mirë e tyre ndodheshin si refugjatë atje. Ndërhyrja austriake pati efekt të menjëhershëm. Qeveria Osmane, e trembur nga ndonjë ndërhyrje e re në punët e saj, lajmëroi më 10 qershor 1911, me anën e shtypit, se Shqiptarët qenë mundur dhe se, me rastin e udhëtimit të Sulltan Mehmetit V në Kosovë, do të shpallej një amnisti e përgjithshme për kryengritësit.<sup>1425</sup>

Udhëtimi i Sulltan Mehmeti V në Kosovë, që filloi me vizitën Shkupit më 11 qershor, ishte plot “tone pajtuese”. Sulltani lavdëronte besnikërinë e Shqiptarëve ndaj Perandorisë dhe premtonte “jetë të përbashkët” dhe “vëllazërore”.

Në Shkup, disa nga prijësit vendorë para masës së madhe që kishte dalë ta priste Sulltanin, i deklaruan “besnikërinë e përjetshme” Perandorisë Osmane. Pas katër ditësh, Sulltani udhëtoi për në Prishtinë, ku nënshkroi një amnisti të përgjithshme për të gjithë pjesëmarrësit në kryengritjet e viteve 1910 dhe 1911. Ndonëse Kosova kishte qenë e njohur për besnikërinë ndaj Sulltanit, pritja që e ftohtë. Në Fushën e Kosovës, ku pritej një manifestim i madh islamist, kishin ardhur njerëz vetëm nga rrethina e katundet e afërta. Qytet si Peja, Gjakova dhe Prizreni nuk kishin dërguar përfaqësues, gjë që dëshmonte se në Kosovës kishte ndodhur një ndryshim i madh.<sup>1426</sup>

Më 18 qershor Shefqet Turgut Pasha bëri të ditur shpalljen e dekretit perandorak për amnistinë. Kryengritësit duhej të ktheheshin brenda dhjetë ditëve dhe të dorëzo-

---

<sup>1424</sup> Skendi, Stavro: *“Zgjimi kombëtar shqiptar”*, Tiranë, 2000, faqe 374.

<sup>1425</sup> Po aty, faqe 375.

<sup>1426</sup> Po aty, faqe 377.



nin armët. Sulltani do t'u bënte një dhuratë 10 mijë lirash turke si dëmshtëpërblim, me ç'rast qeveria do t'u zhdëmtonte malësorëve pasurinë e humbur ose të shkatërruar.

Që "pajtimi" midis Shqiptarëve dhe Osmanëve të mos dukej vetëm si çështje e një konflikti tashmë të mbyllur rreth "vendosjes së rregullit", ku kishte pasur keqkuptime të dyanshme të cilat po tejkaloheshin, por e gjitha të përcillej edhe me një marrëveshje e cila do të mbështetej mbi kërkesa politike, në pajtim me ato që tashmë dilnin nga platforma kombëtare, e që kishin të bënin me autonomi, do të përkujdeset Ismail Qemali me disa nga krerët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, i cili gjatë kësaj kohe ndodhej në Cetinë për të biseduar me kryengritës. Ismail Qemali bashkë me Luigj Gurakuqin dhe me ndërmjetësimin e Komitetit të Podgoricës, më 23 qershor, në pllajën e Greçës (në perëndim të Selcës, në Malësinë e Madhe), thirri Kuvendin e Përgjithshëm të krerëve shqiptarë. Aty u miratua dokumenti më i rëndësishëm i kryengritjes, i njohur me emrin "*Libri i Kuq*" (për shkak të ngjyrës së ballinës së broshurës në të cilin u shtyp), i hartuar nga Ismail Qemali dhe Luigj Gurakuqi.<sup>1427</sup>

Në Memorandum parashtroheshin këto kërkesa:

- *garanci se nuk do të përsëriteshin veprimet antikushtetuese nga qeveria qendrore dhe nga autoritetet lokale në të gjithë Shqipërinë dhe se do të respektoheshin fetë dhe zakonet e vendit;*

- *të njëjtoj kombi shqiptar me po ato të drejtat që kishin kombet e tjera të Perandorisë Osmane;*

- *liri të plotë për zgjedhjet e deputetëve Shqiptarë, numri i të cilëve të ishte në përpjesëtim me popullsinë;*

- *të bëhej bashkimi i vilajeteve, ku jetojnë Shqiptarët, sipas decentralizimit administrativ, dhe të harmonizoheshin ligjet turke me të drejtat zakonore të vendit;*

- *nëpunësit e lartë të dinin gjuhën e zakonet e vendit;*

- *të gjithë nëpunësit civilë dhe financiarë të ishin Shqiptarë, ndërsa gjyqtarët, xhandarët e policët të ishin gjithashtu vendas;*

- *të caktohej një guvernator i përgjithshëm nga Sulltani për një periudhë të caktuar; të përdorej gjuha shqipe në administratë, në gjyqe e kuvende, përkrah turqishtes, që, mbetej gjuhë zyrtare e qeverisë qendrore;*

- *shërbimi ushtarak i detyrueshëm për të gjithë në kohë paqeje të kryhej në vend, ndërsa për banorët e zonave kufitare të organizohej një shërbim i veçantë ushtarak, që do të kryhej në krahinat e tyre, për të ruajtur kufijtë;*

---

<sup>1427</sup> "*Historia e Popullit Shqiptar*", vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 450.

- të ardhurat fiskale të përdorëshin në vend për ndërtime rrugësh, hekurudhash, shkollash e të tjera, të me përjashtim të atyre të doganës, të postës, të telegrafit, të duhanit, të alkoolit dhe të pullave, të cilat ishin monopole të shtetit ose u ishin dhënë të huajve si kapitulacione;

- fshatarëve t'u njihej e drejta për prerjen e pyjeve sipas një takse;

- këshillat e përgjithshëm të kishin të drejtë të jepnin vendime për buxhetin e vilajeteve dhe të kontrollonin shpenzimet;

- të jepeshin fonde të nevojshme për rregullimin e shtëpive e të dëmeve të tjera të shkaktuara nga operacionet e ushtrive Osmane dhe t'u ktheheshin Shqiptarëve armët që u ishin marrë.<sup>1428</sup>

“Libri i Kuq” iu dorëzua nga përfaqësuesit e kryengritësve ambasadorit të Perandorisë Osmane në Mal të Zi, Sadredin Beut. Për të pasur mbështetjen e Fuqive të Mëdha për plotësimin e kërkesave të tyre, një delegacion i kryengritësve, i përbërë nga Luigj Gurakuqi, Dedë Gjo Luli, Sokol Bacaj etj., ua dorëzoi Memorandumin përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha në Cetinë.

Pas më shumë se një muaji, më 30 korrik 1911, ambasadori osman në Cetinë, Sadredin Beu, shpalli në Podgoricë kundërpropozimet e qeverisë osmane ndaj kërkesave të kryengritësve. Ato ishin shumë larg autonomisë, që Shqiptarët kërkuan në Memorandumin e Greçës dhe kufizoheshin vetëm në zonat e kryengritjes.

Me këtë dokument qeveria Xhonturke shpallte amnistinë e plotë për të gjithë pjesëmarrësit e kryengritjes po i dorëzuan armët. Shërbimi ushtarak do të kryhej brenda vilajetit të Shkodrës dhe vetëm një vit në Stamboll. Si drejtorë dhe anëtarë të këshillave administrative do të emëroheshin edhe bajraktarët. *Xhelepi* do të caktohej duke marrë parasysh gjendjen ekonomike të popullsisë. Taksat do të mblihdeshin kur Shqiptarët të ishin në gjendje të paguanin. Armët do të mbaheshin me leje të posaçme. Do të ndërtoheshin në malësi, me mjete të shtetit, dy shkolla fillore ku do të mësohej gjuha shqipe. Do të ndërtoheshin rrugë dhe ura.<sup>1429</sup>

Malësorët në fillim kundërshtuan marrëveshjen, duke kërkuar që vëmendja të përqendrohej tek pikat e Memorandumit të Greçës. Por, përfaqësuesit qeveritarë nuk pranuan që ajo të zgjerohej me kërkesa kombëtare. Te detyruar edhe nga trysnia e qeverisë së Cetinës, e cila ishte marrë vesh me Rusët që të mos përkraheshin kërkesat e Shqiptarëve që kishin të bënin me autonomi, marrëveshja e malësorëve me përfaqësuesit e qeverisë xhonturke u nënshkrua me 2 gusht 1911. Me 5 gusht malësorët fi-

---

<sup>1428</sup> Po aty, faqe 451.

<sup>1429</sup> Po aty, faqe 457.

lluan të kthehen në grupe. Ata që nuk pranuan të ktheheshin, e ndër ta ishte edhe njëri ndër prijësit e kryengritjes Dedë Gjo Luli, qeveria malazeze e internoi përtej Moraçës.

Me këtë qeveria xhonturke, po edhe fqinjët e Shqiptarëve, ia dolën që kryengritjen e Malësisë së Veriut, ta shkëpusin nga konteksti i një kryengritjeje të gjerë si dhe pretendimet që ajo të delte me kërkesa politike të përmasave kombëtare, siç pretendohet me Memorandumin e Greçës, për ta rrudhur në një rebelim lokal, i cili justifikonte si dhunën e shtetit “jashtë mase” për të vendosur “rendin dhe ligjin” dhe po ashtu, në njëfarë mase, arsyetonte edhe reagimet e Shqiptarëve ndaj saj, meqë ajo binte ndesh me traditën e tyre shekullore me të cilat ata ishin vetëqeverisur.

Në përgjithësi kryengritja e Malësisë së Veriut mbeti e shkëputur nga një përgjigje e përgjithshme, dhe madje mund të thuhet, se ishte e gjykuar të dështonte, pse në masë të madhe kahun si dhe përmasat reale ia përcaktuan faktorët e jashtëm: ushtarakët osmanë dhe ndërhyrja e Malit të Zi dhe pjesërisht edhe e Italisë.

Faktori ushtarak osman mund të thuhet se jo rastësisht fushatën e “zbatimit të rendit” do ta fillojë në Malësinë e Veriut, pasi që paraprakisht të ketë kryer punë me Kosovën gjatë pranverës dhe verës së vitit 1910, me ç’rast gjatë veprimeve ushtarake Shefqet Turgut Pasha do të thyejë rezistencën e Shqiptarëve të Kosovës të drejtuar nga feudalët vendorë Isa Boletini, Idriz Seferi, Hasen Budakova, Bajram Curri dhe të tjerë, të shumtën besnikë të Sulltan Hamitit.

“Paqësimi” i Kosovës me anën e një terrori të egër si dhe çarmatasoja e pjesës më të madhe të popullatës si dhe largimi i një pjese të kryengritësve (disa mija sosh) në Mal të Zi, Serbi dhe gjetiu si refugjatë bashkë me prijësit e tyre, Isa Boletinin dhe të tjerë, që do të kërkojnë strehim në Mal të Zi, praktikisht atë e kishte shkëputur nga mundësia e ndërlidhje me Malësinë e Veriut.

Edhe ndërhyrja e Malit të Zi si dhe ajo e Italisë, në zhvillimet e pranverës dhe verës së vitit 1911 në Veri të Shqipërisë kishte pasur ndikim të ndjeshëm që ajo të mbetej e shkëputur dhe jashtë koncepteve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, por jo vetëm kaq. Mali i Zi, edhe pse do të thirret “tek bujaria tradicionale”, që të përkrahë fqinjët Shqiptarë në çaste të rënda, megjithatë gjatë gjithë kohës do të bëjë përpjekje që rezistencën e Shqiptarëve ta drejtojë në përputhje me interesat e veta politike, të cilat kishin të bënin me krijimin e rrethanave që Shqiptarët katolikë t’i shkëpuste nga pjesa tjetër dhe kështu t’i “integronte” në mbretërinë malaziase, me anën e ndonjë autonomie “katolike” (siç ishte ajo e Mirditës), ose që t’i shkëpuste sa më shumë pjesë etnisë shqiptare, duke llogaritur edhe Shkodrën, siç do të veprojë pak më vonë. Nëse gjatë kryengritjes së Kosovës së verës të vitit 1910, kryengritësve të Kosovës do t’u ofrojë mbështetje me armë dhe strehim, dhe këtë do ta

bëjë me përcaktimin se kjo dobësonte aftësinë luftarake të Kosovës dhe njëherësh të Osmanëve - gjë që u shkonte për shtati Malit të Zi e edhe Serbisë – në rastin e Malësisë së Veriut, Cetina do të përqendrohet te fiset shqiptare katolike (Shoshi, Hoti, Gruda, Kuqi e të tjerë), në mënyrë që ata t'i fusë në një konflikt të dyfishtë: me Osmanët dhe me popullsinë shqiptare myslimane të Shkodrës dhe rrethinës. Në këto pjesë do të kemi edhe luftën vëllavrasëse mbi baza fetare. Edhe pse me ndërhyrjen e Ismail Qemalit, Luigj Gurakuqit dhe të atdhetarëve të tjerë, në Kuvendin e Greçës të 23 marsit të vitit 1911, me aprovimin e Memorandumit të Greçës, do të arrihet që kryengritjes së Veriut t'i hiqet hipoteka e luftës së Shqiptarëve për interesat e huaja dhe mbi baza fetare, megjithatë ajo nuk do të jetë e lirë nga ndikimet e tilla. Këtë më së miri e vërteton edhe rasti i aventurës së Italo-Arbëreshit Terenc Toçi dhe veprimtaria e Preng Bibë Dodës në Mirditë, kur ky i pari do t'ia dalë që të shpallë njëfarë Shqipërie “të pavarur” katolike në Gimiz të Mirditës!

Përkundër vështirësive dhe dobësive me të cilat do të ballafaqohet rezistenca e armatosur e viteve 1910 (në Kosovës) dhe 1911 në Malësinë e Veriut (pjesën e Mbi-shkodrës), edhe përkundër pasojave të rënda të cilat do t'i përplasen popullatës vendore gjatë dhe pas fushatave ushtarake, megjithatë ajo do të qesë në pah mospajtimet dhe kundërshtimet e thella të Shqiptarëve me Xhonturqit, të cilat nuk kishin gjasa të hiqeshin. Përkundrazi, ato bënë të ditur atë që quhet pajtim rreth mospajtimeve, që si do të shihet pas pak do të sjellë deri tek shpërthimi i ri dhe përfundimtar, siç do të jetë ai i pranverës dhe verës së ardhshme. Atëherë Shqiptarët bashkërisht do të vendosin për një kryengritje gjithëpërfshirëse për përmbysjen e qeverisjes Xhonturke, siç do të ndodhë në të vërtetë në gushtin e vitit të ardhshëm, me çka pranimi i kërkesave të Shqiptarëve do të sjellë tel Lufta e Parë Ballkanike dhe shpallja e pavarësisë së Shqipërisë.

Shenjat e këtij zhvillimi do të detyrohet t'i shohë dhe madje t'i pranojë edhe qeverisja kapricioze Xhonturke, sapo të nënshkruajë marrëveshjen e Podgoricës me Shqiptarët, kur më 29 shtator Italia do t'i shpallë luftë Perandorisë Osmane dhe me këtë rast do të sulmojë Tripolin. Në këto rrethana qeveria xhonturke do të detyrohet që ndaj Shqiptarëve ta ndryshojë sjelljen dhe madje të tregohet “pajtuese”, duke rikthyer fermanin për rihapjen e shkollave shqipe, të mbyllura para një viti si dhe futjen e gjuhës shqipe në shkollat shtetërore fillore dhe ato të mesme. Mori gjithashtu zotimin se do të financonte që të gjitha shkollat shqipe. Ngjashëm u veproua edhe me lejimin e punës së disa gazetave të ndaluara shqipe si dhe të klubeve kulturore shqiptare. Nga burgjet do të lirohen shumë të burgosur politikë, ndërkohë që nga internimet e gjata do të kthehen shumë nga drejtuesit e rezistencës së arma-

tosur të Kosovës të zhvilluar para një viti. Edhe pse valiu i Shkodrës nuk kishte përmbushur shumë nga zotimet që dëlnin nga pikat e marrëveshjes së Podgoricës, veçmas pikat që kishin të bënin me dëmshpërblimet për shtëpitë e rrëzuara dhe për pronat e shkatërruara, megjithatë me rihapjen e shkollave dhe të gazetave, “fryma e pajtimit” zuri të ndjehej, ani pse Shqiptarët tashmë kishin humbur besimin tek Xhonturqit dhe politika e tyre antishqiptare.

Megjithatë, lufta me Italinë dhe vështirësitë e tjera në pjesët e ndryshme të vendit nga shkak i kursit të ashpër nacionalist-centralist të Xhonturqve, që do të përcillen me pakënaqësi të mëdha kudo, do të krijojnë mundësi për një lidhje të re opozitare. Kështu, në nëntor 1911 u themelua një parti e opozitës e njohur me emrin “*Liri dhe mirëkuptim*” (*Hürriyet ve Itilaf Firkasi*), e cila kishte si një pikë të rëndësishme në programin e saj decentralizimin e gjithë administratës dhe njohjen e të drejtave kushtetuese për të gjitha krahinar kombëtare të Perandorisë Osmane. Shqiptarët luajtën një rol aktiv në parti.

Hasan Prishtina ishte ndër njëmbëdhjetë themeluesit e saj. Po kështu, edhe Basriu nga Dibra dhe Mit’hat Frashëri u anëtarësuan në këtë parti. Kjo parti hyri në marrëveshje me udhëheqjen e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe në dhjetor 1911 nisi të ushtrojë një ndikim vendimtar në Dhomën turke. Duke parë se po përballëshin me një përpjekje të përgjithshme kundër politikës osmane dhe centralizimit të saj fryma e së cilës tashmë kishte përfshirë jo vetëm Shqiptarët por edhe të tjerët, të cilët, të bashkuar në parlament, mund të arrinin suksese, veçmas po që se Perandoria Osmane do të përballej me luftëra të tjera siç ishte ajo e Tripolit me Italinë, Xhonturqit vendosën atëherë të përdorin masën ekstreme për të shpërndarë parlamentin më 18 janar 1912, me qëllim që të siguronin një shumicë absolute në zgjedhjet e ardhshme, me çka do të pengoheshin kërkesat për decentralizim që vinin nga Shqiptarët dhe të tjerët.<sup>1430</sup>

## KRYENGRITJA E KOSOVËS E VITIT 1912 DHE MARRËVESHJA E SHKUPIT ME OSMANËT

Shpërndarja e Parlamentit Osman nga Xhonturqit në çastet kur Perandoria Osmane po përballej me kriza të brendshme - ndër të cilat ajo shqiptare ishte më e rëndësishme - si dhe me ato të jashtme - lufta me Italinë, që do të përfundojë me humbjen e

<sup>1430</sup> Shih raportin e diplomatit Kral drejtuar Aehrenthalit, Selanik, 5 janar 1912, nr. 6 (dokument sekret), HHStA, PA XIV/33, Albanien XXXIV.

Tripolit, qe kalkular prej tyre për të sjellë në parlament një shumicë absolute të Komitetit “*Bashkim dhe Përparim*” në mënyrë që ashtu qeverisja me anën e “dorës së fortë” të kishte edhe mbështetjen dhe “legjitimitetin e plotë” të Parlamentit çka kishte rëndësi për rrethanat dhe rrugën për të cilën ishin përcaktuar Xhonturqit.

Për rreziqet e këtij skenari me pasoja të rënda për vetë Perandorinë Osmane dhe stabilitetin e saj, tërhoqi vërejtjen Hasan Prishtina bashkë me deputetët e tjerë shqiptarë në seancën e fundit të Parlamentit Osman, më 11 janar të vitit 1912, vetëm një javë para se parlamenti të shpërndahej.

Është i njohur fjalimi i Hasan Prishtinës rreth kërcënimit me të cilin përballej vendi “*në kjoftë se Qeveria nuk ndrron politikë e administrim në Shqypni, në kjoftë se Shqiptarët nuk i gëzojnë të drejtat e tyre politike*”<sup>1431</sup>, atëherë “*vendi do të hidhet në kryengritje, do të shpërthejë revolucionin. Dhe njëri ndër të parët që do të marrë në dorë flamurin e revolucionit, ndofta i pari ndër të parët do të jem unë*”.<sup>1432</sup>

Siç pritej, Xhonturqit nuk ua vunë veshin fjalëve të Hasan Prishtinës dhe të ngjashmëve nga parlamentarët shqiptarë. Për ta e rëndësishme ishte fitorja e plotë në zgjedhjet e jashtëzakonshme, meqë ashtu mendohej se “krijohej uniteti” i brendshëm aq i domosdoshëm për t’u ballafaquar me sfidat e shumta dhe të rënda, të cilat ishin edhe më të rënda nga ato që kishte lënë despotizmi hamitian dhe qeverisja e tij. Sa u përket raporteve me Fuqitë e Mëdha, veçmas me Gjermaninë dhe Austro-Hungarinë, ndonëse thirreshin në koncepte perëndimore dhe propagandonin parlamentarizmin kushtetues dhe shtetin laik, sapo erdhën në pushtet humbën në saje të sloganit se “e gjithë bota ishte kundër Perandorisë Osmane”, humbën të gjithë miqtë. Madje, edhe përkrahësit e deridjeshëm të saj, Austro-Hungaria, me aneksimin e Bosnjës dhe Hercegovinës si dhe dhënien e miratimit Bullgarisë që të shpallë pavarësinë e deri te sjellja indiferente ndaj Kretës që të bashkohej me Greqinë, u kthye kundër tyre.

Në këto rrethana, pra të mbetjes pa miq nga jashtë dhe me krijimin e armiqve të brendshëm me shqiptarët, që kishin meritat më të mëdha që i kishin sjellë në pushtet, megjithatë, Komiteti “*Bashkim dhe Përparim*”, që e dinte fuqinë e vërtetë të shqiptarëve, bëri përpjekje që në radhët e veta të përfshijë disa nga përfaqësuesit “e moderuar” Shqiptarë, kryesisht osmanistë për nga bindjet, të cilët u hodhën në garë si kundërkandidatë të liderëve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, për ç’gjë u er-

---

<sup>1431</sup> Prishtina, Hasan: “*Nji shkurtim kujtimesh mbi kryengritjen shqiptare të vjetit 1912*”, Botim i dytë, Bari, 1925, faqe 7.

<sup>1432</sup> Po aty, faqe 7.

dhën ndihmë komitetet vendore si dhe administrata e vendit, pa përjashtuar këtu edhe qarqet militante nga radhët e ushtrisë osmane të ndikuar prej Xhonturqve.

Në këtë fushatë të ashpër, me përjashtim të Hasan Prishtinës, i cili fitoi në saje të autoritetit të madh që gëzonte në Vilajetin e Kosovës, por nuk do të hyjë në parlament, pjesa më e madhe e liderëve kombëtarë shqiptarë humbën garën. Madje, kjo nuk i shkoi përdore as Isamil Qemalit në vendlindjen e tij, ngaqë u mund nga guvernatori i Janinës, Mehmet Avniu, i cili kishte mbështetjen e Xhonturqve. Më 18 prill, kur do të mblidhet parlamenti osman, fitorja e shumicës xhonturke do të jetë 215 nga 222 vende!

Si do të shihet, pikërisht kjo fitore e dhunshme, Xhonturqve do t'u mbesë në fyt, sepse farsa parlamentare dhe manipulimi i kushtetutës deri në skajshmëri, i detyroi shqiptarët t'i bashkojnë radhët për t'iu kthyer një kryengritje të përgjithshme për t'i dhënë fund qeverisjes së Xhonturqve. Nëse Turqit e Rinj, para katër vitesh, kishin ardhur në pushtet me ndihmën e drejtpërdrejt Shqiptarëve dhe të kryengritjes së tyre që kishte detyruar Sulltan Hamitin të rikthejë kushtetutën e vitit 1876 dhe parlamentarizmin, do të jenë po ata Shqiptarë, të cilët me një veprim të ngjashëm, detyruan qeverisjen xhonturke të largohet nga pushteti. Ishte, pra, e domosdoshme një kryengritje e madhe, gjithëpërfshirëse dhe e drejtuar nga një qendër, për të hyrë në një zhvillim i cili duhej të ishte historik.

Vendimi për një kryengritje të përgjithshme u mor në Stamboll, në një mbledhje e mbajtur më 12 janar 1912 në lagjen Taksim, në pjesën europiane. Paraprakisht Hasan Prishtina, i cili në parlamentin osman ishte kërcënuar me një kryengritje të madhe nëse Xhonturqit do të vazhdonin politikën antishqiptare, dhe Ismail Qemali, i cili po ashtu ishte i një mendjeje me të, gjatë disa bisedave kishin marrë në shqyrtim hapat që duhej bërë pas shpërndarjes së parlamentit osman dhe veçmas për përgjigjen që duhej dhënë Lidhjes Ballkanike (e përbërë nga Serbia, Mali i Zi, Bullgaria dhe Greqia), e cila kishte arritur pëlqimin për një luftë të përbashkët kundër Perandorisë Osmane sapo të merrnin sinjalin nga Rusia. Dy liderët më të rëndësishëm të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare paraprakisht kishin krijuar një koncept mbi të cilin do të mbështeteshin vendimet, të cilat duhej të sillleshin rreth dy kërkesave themelore:

- autonomisë administrative në kuadër të Perandorisë Osmane, dhe
- përcaktimit që Shqiptarët të njihen si komb.

Aty ishte edhe qëndrimi se kryengritja shqiptare nuk kërkonte shembjen e Perandorisë Osmane, por nuk mbronte as rrugën centraliste të osmanistëve.

Kështu, mbi këtë platformë, e cila ishte në përputhje me programin kombëtar, duhej të mbahej edhe ky takim, i cili në të vërtetë paraqiste më shumë një marrëveshje për ndarjen e detyrave të secilit veç e veç dhe të përgjegjësisë së grupit në tërësi. Pjesëmarrësit duhej të merrnin detyra dhe përgjegjësi, të cilat duhej zbatuar.

Takimi ishte mbajtur në shtëpinë e Syrja bej Vlorës. Aty, përveç Ismail Qemalit dhe Hasan Prishtinës, si ideatorë të këtij takimi, morën pjesë edhe Syrja bej Vlora, Myfit bej Libohova, Esad pashë Toptani dhe Aziz Vrioni. Në takim ishte i pranishëm edhe Bedri Pejani, që mbajti procesverbalin si dhe Mustafë Aziz Kruja. Mbledhjen e udhëhoqi Ismail Qemali, kurse platformën e kërkesave dhe programin e parashitroi Hasan Prishtina. Pas pajtimit të plotë rreth platformës dhe çështjeve të tjera që kishin të bënin me detyrat e secilit veç e veç, pjesëmarrësit u betuan *“për me i dhanë fund politikës tyrke në çështje të kulturës kombëtare e për me sigurue disa privilegje politike për Shqipëri nuk ka tjetër mjet veç se me fillue me një kryengritje të përgjithshme”*<sup>1433</sup>

“Marrëveshja e Taksimit” Kosovës ia parapa rolin vendimtar në kryengritjen e përgjithshme. Do të ndiqej edhe nga viset tjera shqiptare në përputhje me detyrat e marra në Takim.

Hasan Prishtina mori përsipër që ta drejtonte kryengritjen në Kosovës. Ismail Qemali iu ngarkua detyra që të shkojë në Europë dhe krahas bisedimeve që do të ketë me politikanët dhe diplomatët e rëndësishëm të vendeve të Fuqive të Mëdha, të blejë 15 mijë pushkë dhe të sjellë 10 mijë napolona ari për kryengritjen. Esad pashë Toptani mori përsipër organizimin e një kryengritje në Shqipërinë e Mesme dhe në vilajetin e Shkodrës. Ndërsa Myfit bej Libohova, Aziz Vrioni dhe Syrja bej Vlora morën përsipër organizimin e kryengritjeve në Vilajetin e Manastirit dhe të Janinës. Si do të shihet, detyrat e marra në Takim në tërësi i kreu vetëm Hasan Prishtina.<sup>1434</sup>

Sidoqoftë, Marrëveshja e Taksimit kërkonte veprime të ngutshme nga brenda dhe nga jashtë. Ismail Qemali dhe Hasan Prishtina, dy nga ideatorët e Lëvizje Kombëtare Shqiptare, nisën bisedat me përfaqësuesit diplomatikë të Fuqive të Mëdha të akredituar në Stamboll si dhe me përfaqësuesit e vendeve fqinje, pa marrë parasysh se tashmë ishin lidhur aleancat e ndërsjella të vendeve ballkanike për një luftë të përbashkët kundër Perandorisë Osmane.

Qëndrimi i Shqiptarëve ndaj një aleance të tillë kishte rëndësi të madhe, meqë ajo i takonte edhe të ardhmes së tyre, veçmas kur kihej parasysh se vendet fqinje luftën kundër Turqisë europiane e lidhnin me pushtimin e territoreve shqiptare, të

<sup>1433</sup> Po aty, faqe 10.

<sup>1434</sup> Cana, Zekeria: “Lëvizja kombëtare shqiptare në Kosovë 1908-1912”, Prishtinë 1979, faqe 203.



cilat në programet hegjemoniste prej kohësh ishin kthyer në prioritete nacionale dhe tashmë gjendeshin në hartat e tyre: Kosova si “*Serbi e Vjetër*”, vilajeti Manastirit si Maqedoni bullgare, ndërsa Janina në kuadër të “*Vorio Epirit*”.

Biseda e parë e Ismail Qemalit me ambasadorin austro-hungarez në Stamboll, Pavallisini u soll rreth këtij shqetësimi. Me këtë rast Ismail Qemali u përpoq të dijë se çfarë qëndrimi do të mbante Vjena po qe se Shqiptarët do të arrinin një marrëveshje rreth autonomisë së tyre, ndërkohë që si paralajmërohej prej tyre, kjo do t’u shërbente si shkas vendeve ballkanike (Serbisë, Malit të Zi, Greqisë dhe Bullgarisë) të hynë në luftë me Perandorinë Osmane për ta penguar këtë. Ambasadorit të Vjenës do t’i bëhet me dije përcaktimi i Shqiptarëve për shtet integral me rastin e shembjes së Perandorisë Osmane.<sup>1435</sup>

Edhe pse nga informata që ambasadori vjenez në Stamboll do t’ia drejtojë ministrit të jashtëm të monarkisë së dyfishtë, nuk referohet përgjigjja që i ishte dhënë Ismail Qemalit, pos që thuhet se “u vu në dijeni me qëndrimin tonë rreth ruajtjes së *status quo-s*”, megjithatë, Ismail Qemali të njëjtin shqetësim do t’ia shprehë pak më vonë edhe ambasadorit të Austro-Hungarisë në Paris, Szecsen gjatë turneut që pati nëpër kryeqendrat e Fuqive të Mëdha.<sup>1436</sup>

Gjatë bisedës me ambasadorin e Vjenës në Paris bie në sy përqendrimi te kërkesa se Austro-Hungaria duhet t’u dalë në ndihmë në ato rrethana shumë kritike, veçmas për të parandaluar vendet fqinje që nuk i fshihnin pretendimet për t’u zgjeruar me tokat shqiptare, me gjoja “të drejtën” për t’i çliruar “pjesët e tyre të mbetura nën okupimin e Perandorisë Osmane”. Me këtë rast I. Qemali ia bëri me dije ambasadorit austro-hungarez se për Shqiptarët monarkia e dyfishtë ishte i vetmi vend mbrojtës. Po ashtu, I. Qemali njoftoi ambasadorin austro-hungarez rreth planeve të Shqiptarëve si dhe ato që ata dëshironin t’i arrinin me kryengritjen e përgjithshme, që kishin paraparë për në pranverë. Rezymeja ishte kjo:

*“Ne nuk kërkojmë rrënimin e Perandorisë Osmane, por kërkojmë që ajo të mbetet edhe më tutje e fuqishme, që këtë fuqi ta ruajë me kthimin e besimit të shtetasve të saj, duke ua përmbushur kërkesat e tyre. Për Shqiptarët kjo do të thotë që të fitojnë autonominë administrative dhe t’u pranohet e drejta që të njihen si kombet e barabarta me të tjerët.”*<sup>1437</sup>

---

<sup>1435</sup> Shih raportin e Pallavicinit drejtuar ministrit të jashtëm Ahrenthalit nga Stambolli, me shifrën “tepër sekret”, nga HHSa, PA XIV/9, Albanien V/6.

<sup>1436</sup> Po aty.

<sup>1437</sup> Shih letrën e ambasadorit Szecsen nga Parisi drejtuar Aehrenthalit nr. 38-D, HHSa, PA XIV, Albanien, V/6.

Ambasadori vjenez në Paris shfaqej shumë i matur, por ai megjithatë la për të kuptuar se Vjena nuk do të lejojë zgjerimin e Serbisë apo të Malit të Zi në dëm të tokave shqiptare. Do të bëjë të ditur, se Vjena tashmë, me anën e kanaleve diplomatike, zyrtarisht ia kishte tërhequr vërejtjen Beogradit që të mos ndërmarrë veprime kundër viseve shqiptare. Ai foli edhe për kontaktet me Rusinë që të mos lejojë aleatët e saj në Ballkan të rrezikojnë paqen.<sup>1438</sup>

Përgjigje përafërsisht të ngjashme nga diplomatët vjenezë mori edhe Hasan Prishtina nga një takim që kishte me konsullin e përgjithshëm austro-hungarez në Selanik rreth shqetësimeve të Shqiptarëve rreth rrezikut të pushtimit të tokave të tyre nga fqinjët sllavë dhe grekë, të cilët ndodheshin në fazën e fundit të përgatitjeve për të hyrë në luftë me Perandorinë Osmane.<sup>1439</sup>

Në këto rrethana, kur kriza ballkanike po shkonte drejt ashpërsimeve të mëtutjeshme dhe lufta ishte thujtë e pashmangshme, Shqiptarët në tërësi ishin të përqendruar tek Austro-Hungaria dhe sjellja e saj, pa marrë parasysh si dhe sa mundoheshin ajo që t'i animojë qëndrimet ndaj Shqiptarëve dhe pa marrë parasysh se me çfarë interesash lidheshin ato. E rëndësishme ishte se Monarkia e Dyfishtë nga Shqiptarët e të gjitha shtresave, madje edhe nga fanatikët dhe osmanistët e dëshpëruar pse kishte aneksuar Bosnjën dhe Hercegovinën para katër vitesh, shihej si mbrojtëse e vetme nga shkakut se ruajtja e Shqipërisë nga pushtimet sllave lidhej ngushtë me rolin që duhej ta luanin Shqiptarët në rrethanat e reja pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane dhe, pa marrë parasysh statusin që do ta ketë ajo (autonomi e mbikëqyrur nga jashtë, protektorat ndërkombëtar ose ndonjë formë tjetër), do të shërbente si digë parandaluese ndaj hegjemonizmit sllavo-ortodoks, të dirigjuar nga Rusia, gjë që ishte në interes edhe të Europës.

Kjo pikëpamje ishte shprehur qartë në Kongresin e Berlinit 1878 nga Anglia, kur Lordi Bekonsfild, gjatë seancës së gjashtë, kërkesën e shtruar nga Rusia për tokat që do t'u jepeshin Serbisë dhe Malit të Zi, e kundërshtoi përfshirjen e popujve josllavë (fjala ishte për Shqiptarët) nën qeverisjen e tyre me arsyetimin se "Sllavët shfaqeshin shtypës dhe jo të civilizuar". Këtë qëndrim do ta sqarojë pak më vonë Solsberi, kur do të thotë se me këtë më shumë ishte menduar që ruajtja e tërësisë etnike shqiptare të shërbente si mbrojtje ndaj tyre.<sup>1440</sup>

---

<sup>1438</sup> Shih Vlora, Ismail Qemal: "Kujtime", Tiranë, 1997, faqe 249-251; Buxhovi, Jusuf: "Kthesa historike 3", Prishtinë, 2010, faqe 188.

<sup>1439</sup> Po aty, faqe 188.

<sup>1440</sup> Buxhovi, Jusuf: "Kongresi i Berlinit 1878", Prishtinë, 2008, Protokoll VI, faqe 147.

Zaten, te kjo çështje, me ndonjë dallim të vogël, pajtoheshin edhe Gjermania, e në njëfarë mënyre, pajtohej edhe Italia, e cila mund të pranonte kërke-sën për çfarëdo Shqipërie, me kusht që të mos ishte nën ndikimin e plotë të Vjenës.

Për Shqiptarët, të cilëve gjithnjë e më shumë po u hapej hendeku me Xhonturqit dhe, gjithnjë e më shumë po u afrohej rreziku i gllabërimit nga fqinjët sllavë dhe grekë, thuajse nuk kishte rëndësi se mbi çfarë bazash projektohej Shqipëria dhe ekzistenca e saj nga jashtë. Kryesore ishte që ajo të parashihej dhe të mbështetej, meqë vetëm ashtu mund të sigurohej edhe përkrahja për shtetin shqiptar, i cili duhej të shpallej para se të rrënohej Perandoria Osmane.

Të kësaj natyre do të jenë edhe disa nga kërkesat që Austro-Hungarisë do t'i drejtohen nga pjesë të ndryshme të Shqipërisë dhe Shqiptarëve, ku kishte edhe aso që, në emër të mbrojtjes nga Sllavët, Shqipëria paraprakisht kërkohej të aneksohej. E tillë ishte edhe ajo, që Vjenës do t'i drejtohej nga Ndre Mjeda dhe Don Luigj Bumçi. Klerikët katolikë do t'i bëjnë apel princit trashëgimtar, Franc Ferdinandit, me arsyetimin se Shqiptarët për rrethanat shfaqeshin të pafuqishëm ndaj pushtimeve sllave dhe njëherësh të pambrojtur. Pak më vonë, kërkesë të ngjashme, por me theksimin që ajo të jetë e natyrës ushtarake, Vjenës do t'ia dërgojë edhe Zef Seregji, kryepeshkop i Shkodrës.<sup>1441</sup>

Duket se Vjena, edhe përkundër detyrimeve që kishe ndaj Aleancës Trepalëshe, sidomos me Italinë, me të cilën rreth çështjes së Shqipërisë kohëve të fundit kishte pasur shumë biseda si duhej sjellë po qe se gjendja e *status quo-os* do të rrënohej njëanshëm nga faktorët e jashtëm (mendohej tek fqinjët e Shqiptarëve), nuk kishte përjashtuar ndërhyrjen e njëanshme ushtarake në Shqipëri e Veriut, e cila do të bëhej me pretekstet e detyrimeve që Vjenës i vinin nga marrëveshjet me Perandorinë Osmane nga viti 1652, ku Austro-Hungaria shfaqej si mbrojtëse “e autorizuar” e besimtarëve katolikë në Ballkan, prej nga më vonë do të dalë edhe projekti i njohur “*Kulturprotektorat*”, me ç’rast Austro-Hungarisë i lejohej e drejta e ndërhyrjes në Shqipëri në mbrojtje të Shqiptarëve të besimit katolik. Kjo më së miri shihet edhe nga një raport i besueshëm dërguar Perandorit nga ana e shefit të Shtabit të Armatës së Perandorisë, Schemua, i cili propozonte që në rast se Perandoria Osmane humbiste luftën, të pushtohej menjëherë Kosova, që ashtu të sigurohej lidhja me Shqipërinë e veriut, të cilën ai e konsideronte “pa asnjë kusht” brenda sferës austriake të ndikimit.<sup>1442</sup>

<sup>1441</sup> Buxhovi, Jusuf: “*Kthesa historike 3*”, Prishtinë, 2010, faqe 190.

<sup>1442</sup> Shih: “*Östereich-Ungarns Aussenpolitik 1908-1912*”, Vjenë, 1917.

Edhe Ismail Qemali, si personaliteti më i rëndësishëm i asaj që mund të merrej diplomaci shqiptare e krizës, gjithnjë duke pasur parasysh se grabitjeve sllave nuk mund t'u bëhej ballë ndryshe pos që të merreshin në mbrojtje nga një aleat i fuqishëm europian, i cili ishte në gjendje që të përdorte edhe forcën për qëllime të tilla – pasi që përfundimisht të shkëputet nga iluzioni se ishte Italia ajo që mund t'u ndihmonte Shqiptarëve - nuk do të përjashtojë ndërhyrjen ushtarake të Austro-Hungarisë në Shqipëri që atë ta kthente në një protektorat të përkohshëm. Këto opsione do t'ia parashtrijë ambasadorit vjenez në Paris, Szecsen pasi që do ta sigurojë se Shqiptarët në asnjë mënyrë nuk parashihnin lidhje të veçanta me Italinë dhe as që ekzistonin plane për diç të ngjashme.<sup>1443</sup>

Qëndrimet e Ismail Qemali rreth ndërhyrjes Austro Hungareze në çështjen shqiptare, në ato rrethana kur çdo gjë po shkonte kah një luftë e pashmangshme midis shteteve ballkanike, aleatë të Rusisë (Serbisë, Malit të Zi, Greqisë dhe të Bullgarisë) kundër Perandorisë Osmane, të cilat tashmë kishin lidhur aleanca të ndërsjella ose ishin në rrugë e sipër që ato t'i paraфонin, për Vjenën kishte një domethënie, sepse ato vinin nga njeriu i cili në vazhdimësi, hapur apo fshehtas, si diplomat i Perandorisë Osmane dhe si politikan i saj, kishte kultivuar, por edhe kishte sugjeruar raporte në dëm të Austro-Hungarisë dhe të Gjermanisë e në dobi të Britanisë së Madhe ose Francës. Ismail Qemali, pra për Vjenën ishte më shumë se një kundërshtar, i cili megjithatë, ishte i pashmangshëm si lider i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, e cila për Austro-Hungarinë dhe interesat e saj në pjesën europiane të Perandorisë Osmane kishte domethënie të veçantë, meqë nëpër të ose me të lidheshin sFerhat e interesit që ajo tashmë synonte dhe ishte në rrugë e sipër që me Rusinë t'i baraspeshonte.

Sidoqoftë, Ismail Qemali, pas zik-zakëve të njohura me Greqinë dhe Italinë dhe disa marrëveshjeve tepër të njëanshme me Athinën, të cilat u kritikuan edhe nga shumë atdhetarë shqiptarë, (Konica dhe të tjerë që ishin përcaktuar për Austro-Hungarinë dhe Gjermaninë si mbrojtës të Shqiptarëve), këtë herë ishte i detyruar që me diplomatin austro-hungarez të bisedojë si njeri që kërkon shpëtim e jo si diplomat ose politikan, që është në gjendje të kërkojë, po edhe të japë. Këtë gjë, tashmë e dinte edhe Vjena, e cila kështu do ta trajtë Ismail Qemalin nga ai çast e tutje, duke ia imponuar shumë nga veprimet, të cilat, tashmë ishin të kovertuara në dobi të bërjes së Shqipërisë shtet i pavarur, pa marrë parasysh se në çfarë përmasash do të jetë ajo.

---

<sup>1443</sup> Skëndi, Stavro: "Zgjimi kombëtar shqiptar", Tiranë, 2000, faqe 402.

Në kërkim të mbështetjes nga Vjena vepronte edhe Hasan Prishtina, i cili personalisht kishte marrë përsipër drejtimin e kryengritjes shqiptare në mënyrë që ajo të ishte e ndërlydhur, e bashkërenditur dhe pa kundërthëniet e brendshme, siç kishte ndodhur me rastin e kryengritjes së Kosovës të vitit 1910 dhe të Malësisë së Veriut më 1911. Gjatë një bisede me konsullin e Austro-Hungarisë në Selanik, Kral, Hasan Prishtina bëri të ditur se tashmë ishin shpërndarur të gjitha lidhjet e mundshme me Xhonturqit nga shkakut se panturqizmi i tyre ishte shkatërrimtar dhe nuk ofronte kurrfarë mundësish që të përfillehin kërkesat e Shqiptarëve. Kështu që ai parashikonte një revoltë të përgjithshme në Shqipëri. Ndjenja e identitetit kombëtar, do të theksojë Hasan Prishtina, kishte bërë përparime të konsiderueshme në Kosovën veriore dhe udhëheqësit kosovarë, po punonin pa pushim për të arritur një marrëveshje me pjesët e tjera të Shqipërisë për një kryengritje të madhe. Me këtë rast, Hasan Prishtina përsëriti qëndrimin tashmë të njohur rreth domosdosë për krijimin e një shteti shqiptar brenda një shteti turk të fortë, por Shqiptarët dyshonin në atë mundësi, ngaqë *“në njërin anë, Turqia nuk qe në gjendje të mbahej në këmbë për një kohë të gjatë, se qe duke u shpërbërë, në tjetrën anë, ajo i mbyllte sytë ndaj kërkesave të arsyeshme të Shqiptarëve dhe nuk donte t’i lejonte të ishin të përgatitur për çdo rast.”*<sup>1444</sup>

Krahas përpjekjeve që të sigurohet mbështetja e një aleati të fuqishëm siç ishte Austro-Hungaria - e cila edhe ashtu Shqiptarët dhe hapësirën e tyre etnike e kishte fokusuar në rrethin e sferës së saj të interesit dhe si do të shihet me këto pretendime do të përkrahë dhe mbrojë pavarësinë e Shqipërisë – Ismail Qemali dhe Hasan Prishtina kthyen vëmendjen edhe kah vendet ballkanike, pa marrë parasysh qëndrimet e tyre të njohura.

Hasan Prishtina u përpoq të siguronte bashkëpunimin me lëvizjen bullgare-maqedonase në Shqipërinë Lindore.<sup>1445</sup>

Për këtë qëllim pati një takim me ish-deputetin e Shkupit në Parlamentin Osman, Pavlllov, të cilit iu propozua organizimi i kryengritjes së përbashkët, pa përjashtuar këtu edhe mundësinë e krijimit të një shteti autonom shqiptaro-maqedonas.<sup>1446</sup>

Pavllovi, pasi që të jetë këshilluar me qendrën e lëvizjes bullgare-maqedonase (me verhovistët) në Sofje, u përgjigj se *“Bullgarët nuk mundeshin kurrësi të merrnin pjesë në kryengritje”*.<sup>1447</sup>

<sup>1444</sup> Shih letrën nga Kral drejtuar Aehrenthalit, Selanik 5 janar 1912 nr 6. Sekrete. HHStA, PA XIV/33, Albanien XXXIV.

<sup>1445</sup> *“Historia e popullit shqiptar”*, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 463.

<sup>1446</sup> Po aty, faqe 464.

Kjo edhe pritej, meqë Sofja, e cila tashmë ishte lidhur me fqinjët në kuadër të Aleancës Ballkanike, kishte planet e saj për pushtimin e disa tokave shqiptare.

Për ndryshim nga Sofja, Beogradi, i cili kishte qenë i informuar mirë për qëndrimin e Shqiptarëve që të fillonin kryengritjen e armatosur kundër qeverisjes Xhonturke në pranverë, do të tregojë interesim për të.

Por, Serbia që në nismë përjashtonte nga çfarëdo bisede ose marrëveshje Ismail Qemalin, Hasan Prishtinën dhe pjesën tjetër intelektuale nga radhët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, që kishin marrë pjesë në parlamentarizmin osman dhe lëvizjen Xhonturke, e që lëvizjen e tyre e lidhnin me kërkesa politike siç ishte ajo e autonomisë së Shqipërisë brenda Perandorisë Osmane dhe forma të tjera. Beogradi, për bashkëbisedues kërkonte liderët vendorë, feudalët, bajraktarët dhe pjesën e parisë, e cila edhe më tutje mbetej përkrahëse e Sulltan Hamitit dhe shpresonte se njëri nga qëllimet e trysnisë së kryengritjes kundër qeverisë Xhonturke ishte kthimi i tij në pushtet. Madje, Serbia në këtë drejtim edhe kishte punuar dhe mund të thuhet se kishte pasur edhe fryte, meqë ajo kishte hyrë në lidhje me disa nga krerët e Kosovës, të cilët i kishte përkrahur gjatë kryengritjes së vitit 1910, me ç'rast disave prej tyre edhe u kishte dhënë strehim në Serbi pasi që të kenë pësuar disfatë nga fushata ushtarake osmane e Turgut Pashës. Në përputhje me këtë qëndrim Beogradi sërish kishte hyrë në bisedime me Isa Boletinin, Hasan Hysen Budakovën, Iliaz Agushin, Mahmut Zajmin, Bajram Daklanin, Sadik Ramën e Gjurgjevikut, Ramadan Shabanin dhe të tjerë.<sup>1448</sup>

Disa prej tyre kishin shkuar në Beograd, ku ishin pritur nga ministri i jashtëm Millovanoviq dhe Nikolla Pashiqi. Bëhet e ditur se ministri i jashtëm Millovanoviq u kishte premtuar se qeveria serbe kishte autorizuar konsullin e tyre në Prishtinë, Millojeviq, ku ata do të merrnin ndihma (armë, po edhe të holla), por që ndihma kushtëzohej nga heqja dorë nga çdo synim për të fituar autonominë administrative të Shqipërisë.<sup>1449</sup>

Po ashtu, Serbia, kushtëzonte edhe kohën e fillimit të kryengritjes, e cila duhej të dilte nga një marrëveshje me autoritet serbe.

Beogradi, megjithatë, premtoi furnizim me armë dhe me mjetet të tjera materiale si dhe lejoi kalimin e armëve në Shqipëri nëpër Serbi përmes kontrabandës, e cila, në pragun e shpërthimit të kryengritjes mori përmasa të mëdha.<sup>1450</sup>

---

<sup>1447</sup> Po aty, faqe 464.

<sup>1448</sup> Po aty, faqe 465.

<sup>1449</sup> Shih Cana, Zekeria: "Lëvizja kombëtare shqiptare në Kosovë 1908-1912", Prishtinë 1979, faqe 208.

<sup>1450</sup> "Historia e Popullit Shqiptar", II, Tiranë, 2002, faqe 465.

Qëndrimi refuzues i Sofjes ndaj çfarëdo bashkëpunimi me kryengritjen shqiptare dhe ai me kushtëzime i Beogradit, nuk do të ndalin rrjedhën që i ishte paraparë në përputhje me Marrëveshjen e Taksimit. Votimet e reja për parlamentin osman nën trysinë e Xhonturqve, ku humbën shumica e liderëve shqiptarë, pastaj mos-përmbushja e shumë nga premtimet që do t'u jepen Shqiptarëve të Veriut pas shtypjes së kryengritjes së tyre sapo ata të pranojnë të kthehen nga strehimi në Mal të Zi si dhe dobësi të tjera të qeverisjes xhonturke, krijuan një klimë të përshtatshme në dobi të kryengritjes shqiptare. Duke parë se ajo ishte e pashmangshme, autoritetet xhonturke, në prag të zgjedhjeve dhe gjatë tyre, bënë përpjekje që me anën e disa lëshimeve (rihapja e disa shkollave shqipe dhe fillimi i ndërtimit të disa rrugëve në Veri), të japin shenja pajtimi, por pa hequr dorë nga centralizmi dhe nacionalizmi osman.

Për këtë qëllim qeveria xhonturke krijoi një komision qeveritar të kryesuar nga ministri i Brendshëm Haxhi Adil beu, i cili do të vizitojë Shqipërinë dhe atje do të bisedojë me parinë vendore si dhe me popullin rreth një bashkëpunimi që qeverisja të ishte edhe në përputhje me nevojat dhe interesat e Shqiptarëve. Komisioni qeveritar, që u quajt i reformave, i kryesuar nga Ministri i Brendshëm Haxhi Adil beu, jo rastësish filloi vizitën e tij në Kosovë, meqë dinte se atje tashmë kishin filluar përgatitjet për një kryengritje të re. Këtë pati rastin ta hetojë në Prishtinë, kur delegacioni qeveritar osman i një niveli të lartë, u prit ftohtë, ndërsa në rrugë e sipër për në Pejë e Gjakovë, në afërsi të Strellcit, u sulmua nga forcat kryengritëse të drejtuara nga Mahmut Zajmi i Pejës. Ngjashëm do të pritët edhe në pjesët të tjera, në Shqipërinë e Mesme e të Jugut, deri në Manastir dhe Janinë, meqë u pa, se gjatë kësaj vizite ministri i brendshëm, një pjesë të mirë të vëmendjes ia kishte kushtuar manipulimit të vendvotimeve, të cilat kishin për qëllim fitoren sa më të thellë të kandidatëve të Komitetit "*Bashkim dhe Përparim*" në viset shqiptare, që edhe do të ndodhë me çka u krijuan rrethana edhe më të përshtatshme për fillimin e kryengritjes.<sup>1451</sup>

Largimi pa ndonjë fryt i komisionit qeveritar të kryesuar nga ministri i Brendshëm Haxhi Adil beu si dhe shpallja e fitores thujse absolute të kandidatëve të Xhonturqve në të gjitha qendrat shqiptare, duke eliminuar pjesën më të madhe të krerëve shqiptarë, ia hapi rrugën fillimit të kryengritjes së Kosovës, e cila, në përputhje me Marrëveshjen e Taksimit, duhej të përfshinte, pa përjashtim, gjithë Shqipërinë.

---

<sup>1451</sup> Shih Cana, Zekeria: "*Lëvizja kombëtare shqiptare në Kosovë 1908-1912*", Prishtinë, faqe 214-218.

Hasan Prishtina përfundimisht kishte braktisur Stambollin dhe, në përputhje me premtimin që kishte dhënë në mbledhjen e fundit të parlamentit osman, më 11 janar 1912, se nëse vazhdohet politika antishqiptare e qeverisë xhonturke “*fortelen e parlamentit do ta zëvendësonte me malet e Kosovës*”, vihet në krye të punëve që kryengritja në Shqipëri të fillonte siç ishte paraparë dhe të merrte kahun e duhur për t’u kthyer në një strumbullar të lëvizjes gjithëshqiptare.

Largimi i Hasan Prishtinës nga Stambolli dhe kthimi në Kosovë, kishte të bënte me vendimin që “Komiteti Qendror i Kryengritjes”, kishte marrë në prill të vitit 1912 pas sesionit të çeljes së parlamentit të ri, të fillohej kryengritja e përgjithshme në Shqipëri, qendra e së cilës do të ishte Kosova.<sup>1452</sup>

Në përputhje me këtë vendim, Hasan Prishtina kaloi në Kosovës. Lidhjet e para me disa nga prijësit vendorë dhe feudalët, të cilët prej kohësh gjendeshin në gjendje lufte me qeverisjen Xhonturke, H. Prishtina i mori në Shkup dhe Prishtinë. Pastaj filloi të marrë lidhjet me drejtuesit e çetave kryengritëse që vepronin në hapësirën midis Gjakovës dhe Pejës, që drejtoheshin nga Muhmut Zajmi, Zefi i Vogël, Ali Binaku, Qerim Binaku, Bajram Mani, Zog Avdyli, Bajram Daklani e të tjerë. Këto çeta, të cilat gjatë vizitës së ministrit të brendshëm, Haxhi Adil beu, kishin dhënë dëshmi se ishin në gjendje që të luftonin, duhej ndërlidhur me një qendër të përbashkët në mënyrë që të bashkëvepronin.

Nga Dukagjini Hasan Prishtina kaloi në Drenicë, ku u mbështet nga AhmetDelia në Prekaz dhe Sadik Ramë Gjurgjeviku në rrethinat Pejës. Aty, me një vone-së, Hasan Prishtinës iu bashkua edhe Isa Boletini me disa bashkëluftëtarë. Kjo ish-te arsyeshme, meqë Isa Boletinin, armiqësia me Xhonturqit e kishte bërë mosbesues edhe ndaj disa liderëve Shqiptarë (deputetë në parlamentin e parë), të cilët kishin përkrahur lëvizjen Xhonturke dhe kishin bërë që në Ferizaj para katër vitesh Shqiptarët t’i sillnin në pushtet ata, që si do të shihet, së pari do t’ua kthejnë shpi-nën Shqiptarëve dhe kërkesave të tyre. Në ato rrethana, Isa Boletini, kishte interes jo vetëm që të rrëzohej qeverisja e Xhonturqve, por të rikthehej në pushtet edhe Sulltan Hamiti. Ky qëndrim do të ketë pasoja me rastin e Memorandumit të Shkupit dhe hapte dilemën e ndërvarjes ose lidhjes së liderëve nga Kosova me interesat e ndryshme, që ishin të angazhuara ta dirigjonin lëvizjen shqiptare në përputhje me interesat e tyre nga jashtë, rëndom të maskuara mirë e mirë “me

---

<sup>1452</sup> Shih I.G. Senkevich: “*Osvoditel’noe dvizhenie albanskogo naroda v 1905-1912*”, Moskë, 1959, faqe 217.



anën e përkrahjes vëllazërore” dhe parulla të ngjashme, që pinin ujë te Shqiptarët besues.<sup>1453</sup>

Pavarësisht prej atyre që Isa Boletini kishte në mendje, dalja e tij në anën e kryengritjes, kishte rëndësi, sepse ishte një autoritet i rëndësishëm në pjesën veriore të Kosovës. Edhe Nexhip Draga, po ashtu ia kishte dalë që të bënte për vete krahinën e Shalës, që edhe kjo të bashkohej me kryengritjen. Aty ishte mbajtur një kuvend me krerët e kësaj pjese, ku edhe ishte lidhur besa. Draga, megjithatë, personalisht nuk do t’i bashkohet kryengritjes me arsyetime “shëndetësore”, por do të shfrytëzojë të gjitha mundësitë që kryengritja të ketë sukses. Megjithatë, arsyet pse ai fizikisht nuk do t’i bashkohet kryengritjes, kanë të bëjë me disa hesape që kishte me Isa Boletinin rreth pronave në veri të Mitrovicës, të cilat qeverisja e Xhonturqve ia kishte marrë Isës dhe ia kishte dhënë si koncesione të pyjeve Dragës, ku ai kishte ndërtuar një sharrë avulli dhe një ndërmarrje për prerjen e pyjeve. Duke ditur rëndësinë e njërit dhe të tjetrit, Hasan Prishtina do të bëjë çmos që shfrytëzojë fuqinë ushtarake të Isa Boletinit dhe atë diplomatike-politike të Dragës për nevojat e Kryengritjes. Kështu që edhe pa qenë i pranishëm Nexhip Draga, emrin e tij do ta vejë në të gjitha thirrjet dhe informatat tjera për opinion, sepse ashtu mbante të lidhur për Lëvizjen Kombëtare një njeri të rëndësishëm.<sup>1454</sup>

Pasi që të jenë marrë vesh për mënyrën e veprimit si dhe ndërlidhjen me një qendër komanduese, në fillim të majit çetat e Dukagjinit, të kryesuara nga Mahmut Zajmi dhe Zefi i Vogël, sulmuan forcat osmane në rrethinë të Pejës dhe u shkaktuan humbje të ndjeshme. Me këto veprime u vështirësua lëvizja e forcave ushtarake osmane në drejtim të Mitrovicës, ku po ashtu kishin filluar veprimet luftarake.<sup>1455</sup>

E përballuar me sulme të tilla, që paralajmëronin një kryengritje të përmasave të mëdha, Porta e Lartë, vazhdoi të përqendronte në Kosovë forca të reja ushtarake. Nga fundi i majit në Ferizaj arriti divizioni i nizamëve nga Stambolli, i specializuar për kryerjen e detyrave të veçanta dhe i pajisur me armatime e mjete moderne luftarake. Forcat ushtarake osmane, të komanduara nga Komandanti i Korpusit të 7-të të Shkupit, gjeneral Ismail Fadil Pasha, po bëheshin gati, por dukej se qeveria xhonturke fillimisht nuk ishte e interesuar për një fushatë ndëshkimore të ngjashme me atë të Shevqet Dervish Turgut Pashës.<sup>1456</sup>

---

<sup>1453</sup> Cana, Zekeria: “Lëvizja kombëtare shqiptare në Kosovë 1908-1912”, Prishtinë 1979, faqe 220-221.

<sup>1454</sup> Më gjerësisht rreth Nexhip Dragës dhe rolit të tij në Kryengritjen e vitit 1912 shih: Prishtina, Hasan: “Nji shkurtim kujtimesh”, Bari 1925.

<sup>1455</sup> Cana, Zekeria: “Lëvizja kombëtare shqiptare në Kosovë 1908-1912”, Prishtinë 1979, faqe 221.

<sup>1456</sup> Gawrych, George: “Gjysmëhëna dhe shqiponja”, Tiranë, 2007, faqe 293.

Sukseset e para luftarake të kryengritësve në pjesë të ndryshme të Kosovës shtruan si një detyrë të ngutshme bashkërendimin dhe organizimin e kryengritjes në shkallë kombëtare me kërkesa dhe program politik. Kthimi i Hasan Prishtinës në Kosovë bashkë me veprimtarë të tjerë kishte krijuar rrethana të mira që Kryengritja e Kosovës të kthehej në një pishtar të Lëvizjes Kombëtare në përputhje me Marrëveshjen e Taksimit. Gjatë takimeve të para me liderët vendorë dhe prijësit e çetave, Hasan Prishtina kishte kërkuar që Kryengritja të kishte për moto kërkesën “*Liri administratore të Shqypënisë*”, pra autonominë. Kërkesa ishte nënshkruar nga Mahmut Zajmi, Bajram Daklani, Zefi i Vogël, Pjetër Çeli, Halil Mehmeti, Idriz Jaha, Hasan Bllaca dhe nga Sali Hoxhë Elbasani.<sup>1457</sup>

Kjo dhe sukseset e treguara në zgjerimin e lëvizjes kryengritëse shtroi nevojën e bashkimit të të gjitha forcave rreth një programi politik kombëtar. Kështu, me nismën e Hasan Prishtinës, u vendos që në Junik të thirrej një kuvend kombëtar. Paraprakisht ai do të zhvillojë takime të shumta me disa nga krerët e Kosovës, të cilët kishin ambicie të ndryshme dhe jo rrallë ato i kishin shtyrë që interesat kombëtare t’ua nënshtronin atyre personale, duke hyrë në lidhje të njëanshme me Beogradin, Cetinën ose qendrat e tjera, të cilat ishin të interesuara që lëvizja shqiptare të mos kishte qendër drejtuese e as bashkim të brendshëm, por të mbetet pre e ndikimeve të jashtme, qysh kishte ndodhur para dy vitesh.

Kuvendi u mbledh në Junik më 21-25 maj 1912. Në të morën pjesë 250 delegatë nga Vilajeti i Kosovës, si dhe nga sanxhaqet e Dibrës, të Shkodrës dhe të Elbasanit. Ishin edhe disa përfaqësues të krahinave të Jugut, ani pse kjo nuk mund të dokumentohet nga shënimet e mangëta e as nga ato përcjellëse.<sup>1458</sup>

Në kuvendin e Junikut, ku morën pjesë Hasan Prishtina, Isa Boletini, Bajram Curri, Riza Kryeziu, Nexhip Draga, Sefer Neziri - Kleçka dhe të tjerë, pajtimi për kryengritjen u arrit mbi bazën e luftimit që duhej t’i bëhej Komitetit “*Bashkim dhe Përparim*” dhe në përgjithësi qeverisjes së Xhonturqve dhe këtu ishte edhe çelësi i bashkimit të të gjithë Shqiptarëve, veçmas të forcave feudale, të cilat kishin arsye të shumta që Xhonturqve t’u hakmerreshin për fushatën që ata kishin ndërmarrë kundër tyre para një viti. Për këtë u lidh edhe *Besa*.<sup>1459</sup>

Deri tek arritja e *Besës*, që të luftohej Komiteti Xhonturk dhe qeverisja e tyre, do të kalohet nëpër një konfrontim të fuqishëm me rrymën turkomane, e cila ishte e pranishme në Kuvend dhe nuk ishte e pajtimit që qeverisë xhonturke t’i shpallej

---

<sup>1457</sup> “*Historia e popullit shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 470.

<sup>1458</sup> Po aty, faqe 470.

<sup>1459</sup> Cana, Zekeria: “*Lëvizja kombëtare shqiptare në Kosovë 1908-1912*”, Prishtinë 1979, faqe 230-233.

një luftë e tillë, sepse kjo dëmtonte Perandorinë Osmane e me këtë edhe interesat e shqiptare. Mytesarifi i Pejës, kishte dërguar në Kuvend një mision “të paqes”, i cili kërkonte që Shqiptarët dhe qeveria xhonturke të bisedonin në vend se të luftonin dhe me marrëveshje t’i zgjidhnin mospajtimet. Por, si do të shihet, rryma autonomiste, do të jetë më e fortë dhe ajo do të fitojë. Me këtë rast Kuvendi miratoi programin politik i cili shtronte këto kërkesa:

- *Njohjen e autonomisë së Shqipërisë;*
- *Vendosjen e administratës shqiptare;*
- *Caktimin e gjuhës shqipe me alfabetin kombëtar si gjuhë zyrtare;*
- *Ngritjen e flamurit shqiptar në të gjithë vendin;*
- *Emërimin e një stërnipi të familjeve “princore” shqiptare si guvernator të përgjithshëm dhe Garancinë e Fuqive të Mëdha për plotësimin e këtyre kërkesave.<sup>1460</sup>*

Këto vendime iu dorëzuan qeverisë së Stambollit si dhe u shpërndanë në kuvendet dhe komitetet e viseve të tjera të Shqipërisë, të cilat edhe u përkrahen.

Hasan Prishtina dhe atdhetarët e tjerë iu vunë punës për të vënë në jetë vendimet e “Kuvendit të Junikut”.

Ai lëshoi një shpallje drejtuar “*Shqiptarëve liridashës dhe botës së qytetëruar*” ku lufta për autonominë e Shqipërisë paraqitej luftë kundër zullumit, shtypjeve dhe administratës antishqiptare të Xhonturqve dhe i ftonte të gjithë dashamirët e mirëqenies dhe të lirisë në Perandori që të përkrahin luftën e Shqiptarëve, sepse “*Atdheu pret prej nesh bashkimin. Dita a sot e minutat janë afrue për me pështue prej të këqijave të jene-Turqve.*”

Shkrimi përfundonte me thirrjen:

*“A shpëtim a vdekje!”<sup>1461</sup>*

Meqë qeveria osmane nuk do t’u japë kurrfarë përgjigje kërkesave që iu shtruan nga “Kuvendi i Junikut”, ishte e natyrshme që kryengritësit të viheshin në veprim. Nga mesi i majit, të parët u hodhën në luftë kryengritësit që vepronin në Rrafshin e Dukagjinit dhe që udhëhiqeshin nga Hasan Prishtina dhe Bajram Curri.<sup>1462</sup>

Veprimet luftarake pastaj do të zgjerohen në drejtim të Pejës, me ç’rast forcat e drejtuara nga Isa Boletini, Bajram Daklani, Sadik Rama, Mahmut Zajmi dhe Zefi i Vogël, më 31 maj sulmuan Pejën, ku asgjësuan pozicionet ushtarake dhe postet e xhandarmërisë të rrethinave të saj. Më 6 qershor kryengritësit hynë në Pejë, po nuk mbetën gjatë, meqë forcave osmane do t’u vijë në ndihmë Divizioni XIX i niza-

<sup>1460</sup> Po aty, faqe 471.

<sup>1461</sup> Prishtina, Hasan: “*Nji shkurtim kujtimesh*”, Bari, 1925, faqe 28.

<sup>1462</sup> “*Historia e popullit shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 472.

mëve nga Mitrovica, kështu që u desh të tërhiqeshin në drejtim të Gucisë, ku edhe do të përqendrohen gjatë veprimeve të mëtutjeshme në këtë pjesë.<sup>1463</sup>

Kryengritësit do të vazhdojnë të sulmojnë forcat osmane edhe në pjesë të tjera në drejtim të Qafës së Prushit dhe të Përdrinit. Forcat që drejtonte Bajram Curri vepronin me sukses në Has, Gash dhe Bytyç dhe ia dolën që të thyejnë forcat qeveritare në Qafë të Prushit, duke lënë në duar të Shqiptarëve municione, armë, mitraloza dhe topa, që u përdorën për armatosjen e kryengritësve. Ata lanë gjatë luftimeve rreth 300 të vrarë dhe shumë të plagosur. Për herë të parë forcat kryengritëse zunë rob lufte.<sup>1464</sup>

Që në ditët e para, kryengritja e Gjakovës dhe e Pejës u përkrah edhe nga popullata shqiptare e besimit katolik e Mërturit dhe e Nikajve. Mirdita shpejt u bashkua me ta. Përpjekjet e Osmanëve për të përdorur dallimet fetare dhe ta vinin Mirditën midis myslimanëve të Shkodrës dhe të Krujës, nuk patën sukses.<sup>1465</sup>

Bëhet e ditur se edhe Kruaja dhe Tirana, të cilat ishin duke u përgatitur për kryengritjen, në fund të qershorit u bashkuan me kryengritësit e Mirditës dhe Zadrimes. Kryengritja po ashtu gjeti përkrahje në popullsinë e Shkodrës, e cila formoi një komitet kryengritës. Kështu, lëvizja kundër Xhonturqve pushtoi jo vetëm qytetet katolike, të njohur prej një kohe të gjatë për armiqësinë e tyre ndaj qeverisë, por edhe qytetet myslimane. Kryengritja tani u intensifikua në Dibër dhe në krahinat shqiptare në jugperëndim të saj.<sup>1466</sup>

Edhe në krahinat e jugut, ku bejlerët shqiptarë nuk e shihnin me sy të mirë qeverinë xhonturke, sidomos Komitetin "*Bashkim dhe Përparim*", nisi të hapet fryma e kryengritjes që kishte filluar në Kosovë dhe të përkrahet ajo. Kolonia e Bukureshtit kishte dërguar si përfaqësues të vetin në Shqipërinë e Jugut Pandeli Calën nga Korça, për të ushtruar ndikim mbi të krishterët ortodoksë që bashkë me Shqiptarët myslimanë t'i bashkoheshin kryengritjes që kishte filluar në Kosovë dhe po zgjerohej dita-ditës.<sup>1467</sup>

Sukseset e kryengritjes në Kosovë si dhe zgjerimi i saj në Shqipërinë e Veriut dhe atë të Jugut, bënë që edhe qarqet opozitare brenda armatës osmane të shfaqnin pakënaqësinë e tyre ndaj qeverisjes xhonturke, e cila në vend se të përqendrohej në luftë kundër italianëve në Tripoli, ajo shtonte forcat e armatosura në Kosovë

---

<sup>1463</sup> Zana, Zekeria: "*Lëvizja kombëtare shqiptare në Kosovë 1908-1912*", Prishtinë 1979, faqe 234.

<sup>1464</sup> Po aty.

<sup>1465</sup> Skëndi, Stavro: "*Zgjidhja kombëtare shqiptare*", Tiranë, 2002, faqe 384.

<sup>1466</sup> Po aty, faqe 384.

<sup>1467</sup> Raporti i konsullit Kral drejtuar Bertcholdit, Sekanik, 23 qershor 1912, nr. 102 (sekret), HHStA, PA XIV/39, Albanien XXXIV.

dhe viset tjera shqiptare duke hapur fronte të brendshme me rreziqe të mëdha për Perandorinë, veçmas kur dihej se tashmë Aleanca Ballkanike midis Serbisë, Malit të Zi, Bullgarisë dhe Greqisë në forma dhe drejtime ishte lidhur dhe pritej çasti i duhur për një luftë kundër Perandorisë Osmane.

Kështu, nga fundi i majti, një grup oficerësh, kryesisht turq, krijuan një shoqëri të fshehtë në Stamboll, e cila u quajt “*Grupi i oficerëve shpëtimtarë*” (*Halaskar Zabitan Gurubu*). Ata kërkonin t’i jepnin fund despotizmit të Komitetit “*Bashkim dhe Përparim*” dhe ndërhyrjes së Xhonturqve në ushtri dhe nxorën një program politik për këtë qëllim.<sup>1468</sup>

Shqiptarët vunë lidhje me oficerët opozitarë si dhe me partinë opozitare “*Hürriet ve ittılaf*” (*Liri dhe marrëveshje*). I suksesshëm komunikimi ishte veçmas me opozitarët ushtarakë, ngaqë shumica e oficerëve dhe ushtarëve Shqiptarë në Rumeli tashmë i takoni “*Grupit të oficerëve shpëtimtarë*” dhe prisnin rastin që t’i qëronin hesapet me qëndrimin antishqiptar të Xhonturqve. Kështu, më 21 qershor 1912 një grup oficerësh e ushtarësh (8 oficerë dhe 140 ushtarë) të batalionit të parë të regjimentit të 49-të të këmbësorisë, të udhëhequr nga oficeri shqiptar Tajar Tetova, i njohur për ndihmesën e madhe që kishte dhënë në fitoren e Revolucionit Xhonturk (1908), lanë kampin pranë Manastirit dhe dolën në mal. Së bashku me Tajar Tetovën dolën në mal edhe oficerët të tjerë shqiptarë: Xhelal Preveza, Kasem Kolonja, Melek Kolonja (Frashëri) dhe Ahmet Bejtaga (Kavaja). Më pas me kryengritjen u bashkuan reparte të tëra, si batalioni që komandohej nga major Xhenabi Adil Gjakova.<sup>1469</sup>

Dezertimi i ushtarakëve shqiptarë dhe turq nga formacionet ushtarake osmane vazhdoi edhe në pjesët tjera. Në Dibër komitetit të atjeshëm kryengritës që drejtohej nga Dan Cami, do t’i bashkohen edhe oficerët Ismail Haki Devaja, Ismail Haki Libohova dhe Ibrahim Gjakova.<sup>1470</sup>

Oficerët e arratisur më 21 qershor dolën me një publikim ku bënin të ditur për arsyet e arratisjes. Regjimi xhonturk, thuhej, po e shkatërronte Perandorinë dhe rendin kushtetues me një qeverisje e cila kishte sjellë politikën e padrejtësive dhe të terrorit, që po e ushtronin prej vitesh në Shqipëri. Në shpallje më tutje thuhej se ishin arratisur për t’u solidarizuar me bashkatdhetarët shqiptarë, të cilët kanë ngri-

---

<sup>1468</sup> Gawrych, Geogre: “*Gjysmëhëna dhe shqiponja*”, Tiranë, 2007, faqe 294.

<sup>1469</sup> “*Historia e popullit shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 474.

<sup>1470</sup> Po aty, faqe 474.

tur krye për të treguar atdhetarizmin e tyre dhe vetëmohimin patriotik kundër të gjithë atyre që i kanë sjellë vendit gjithë ato të këqija.<sup>1471</sup>

Ushtarakët kërkonin dorëheqjen e menjëhershme të qeverisë, shpërndarjen e parlamentit dhe dekretimin e zgjedhjeve të reja, dërgimin në gjyq të personaliteteve më të lartat të qeveritare, ushtarake e politike xhonturke, si Ibrahim Hakiun, Mehmet Shefqetin, Said e Rifat Pashën, Talat e Xhavit Beun, si dhe shefin e shtabit të përgjithshëm. Ata deklaruan se pa u plotësua këto kërkesa nuk do t'i lëshonin armët.<sup>1472</sup>

Midis oficerëve opozitarë u zhvilluan debate rreth asaj se çfarë qëndrimi duhej mbajtur ndaj kërkesave politike të Shqiptarëve, veçmas asaj për autonominë që ishte ngritur në “Kuvendin e Junikut” dhe përbënte thelbin e programit politik të Shqiptarëve.

Oficerët shqiptarë, krahas rrëzimit të qeverisë, zgjedhjeve të reja parlamentare, kërkuan që opozita ushtarake të mbështeste kërkesën e Shqiptarëve për autonomi politike, sepse ajo ishte edhe në të mirën e vendit. Pjesa më e madhe e ushtarakëve turq i mbetën besnikë frymës *itilafe*, pr.a asaj që kërkonte ndërrimin e qeverisjes “nga e keqja”, siç quhej ajo Xhonturke, tek “e mira”, që duhej të dilte nga zgjedhjet e reja, por pa u ndryshuar fryma osmaniste.

Edhe përkundër këtyre dallimeve mbi këtë pikëpamje, nuk pati ndonjë konfrontim midis “Grupit të oficerëve shpëtimtarë”. Sepse, edhe opozita turke, e edhe ajo ushtarake ishin të interesuara për fuqinë e Shqiptarëve dhe kërkonin të përfitonin nga kryengritja shqiptare dhe përmasat e saj gjithnjë e më të fuqishme për t'i rrëzuar nga pushteti Xhonturqit, të cilët atë e kishin nga ndihma e Shqiptarëve.

Kjo dilemë nuk do të anashkalojë vetë Shqiptarët, e cila do t'i preokuponte sa më shumë që kryengritja rritej dhe fitonte shtrirje të gjerë. Edhe pse në “Kuvendin e Junikut” ishte vendosur për kërkesat politike, të cilat lidheshin me autonominë e Shqiptarëve brenda Perandorisë Osmane, megjithatë zhvillimet e jashtme, sidomos Aleanca e vendeve Ballkanike kundër Perandorisë Osmane dhe rreziku që trojet shqiptare prapë të copëtoheshin nga fqinjët, bënë që udhëheqësit e kryengritjes të harmonizonin disa nga qëndrimet e tyre me atë të opozitës dhe të ushtarakëve, duke u tërhequr përkohësisht nga platforma e miratuar në “Kuvendin e Junikut”.

Në fund të qershorit ata botuan në gazetën “*Ikdam*” një deklaratë të nënshkruar ndërmjet të tjerëve edhe nga Hasan Prishtina, Isa Boletini, Riza Gjakova,

---

<sup>1471</sup> Po aty, faqe 474.

<sup>1472</sup> Po aty, faqe 474.

Jahja Prizreni e të tjerë, e cila ishte formuluar në frymën e kërkesave të opozitës. Pasi theksonin lidhjet e tyre me Perandorinë Osmane dhe me Kalifatin, ata shpallnin se ishin ngritur për të mbrojtur “konstitucionin e vërtetë”, që ishte qëllim i përbashkët i të gjitha forcave opozitare të Perandorisë Osmane.<sup>1473</sup>

Në deklaratën e krerëve të kryengritjes së Kosovës thuhej gjithashtu se Shqiptarët qenë të detyruar t’u drejtoheshin armëve për shkak të nevojës që kishte vendi për disa ligje, në përputhje me kushtet e veçanta. Me këto ligje nënkuptohej edhe plotësimi i të drejtave kombëtare. Megjithatë, as ato dhe as kërkesat e autonomisë së Shqipërisë nuk përmendeshin në këtë deklaratë.<sup>1474</sup>

Tërheqja “taktike” nga kërkesa për autonomi do t’i bashkojë edhe më shumë kryengritësit shqiptarë me opozitën osmane si dhe me lëvizjen e ushtrisë në vilajetin e Kosovës dhe të Manastirit rreth të njëjtit qëllim: rrëzimit të qeverisë. Kështu, faktori ushtarak, jo vetëm që futej në lojë, siç kishte ndodhur gjatë revolucionit të vitit 1908, por ai fitonte gjithnjë e më shumë në peshë, sepse krahas dezertimit që bënte në frontet e luftës me Shqiptarët duke dobësuar mundësitë e një fushate kundër tyre siç ishte ajo e para një viti e Turgut Pashës, armata bënte trysni të drejtpërdrejtë tek qeveria xhonturke që ajo të largohej dhe t’ua lëshonte vendin zgjedhjeve të reja, edhe pse parlamenti i dalë nga zgjedhjet sapo ishte konstituuar. Kështu, oficerët e Armatës së gjashtë në Manastir kërkuan dorëheqjen e qeverisë, e cila, u arsyetua edhe me kryengritjen e Kosovës.<sup>1475</sup>

Trysnia e oficerëve në njërën anë, të cilët dezertorin dita ditës dhe shumë prej tyre kishin dalë maleve, dhe në tjetrën anë, ajo e kryengritësve Shqiptarë, të cilët gjithnjë e më shumë zgjeroheshin, duke i dhënë luftës së tyre përmasa kombëtare. Kjo do të pasqyrohej edhe me përfshirjen e çetave të jugut në veprimet luftarake kundër forcave osmane, siç ishin ato të Themistokli Germenjit, Sali Butkës, Spiro Bellkamenit, Menduh Zavalanit etj - bënë që Said Pasha të japë dorëheqjen. Paraprakisht, më 9 korrik, dorëheqje do të japë ministri i luftës Mahmut Shefqet Pasha, arkitekt i dorës së fortë, i cili do të vijë në pushtet pasi që do të shuajë të ashtuquajturin kundërrevolucion të vitit 1909, por që me disfatat e fundit në Kosovë dhe lëvizjen e revoltës brenda armatës, ishte kthyer në një shënjestër që qëllon nga të gjitha anët.

---

<sup>1473</sup> Po aty, faqe 476.

<sup>1474</sup> Po aty, faqe 476.

<sup>1475</sup> Shih raportin e besueshëm nga Halla drejtuar Bertchtoldit, Manastir, 27 qershor 1912, nr. 65, HHStA, PA XIV/39, Albanien XXXIV.

Më pas, më 21 korrik, Mehmeti V zgjodhi Gazi Ahmet Muhtar Pashën, president të senatit, me detyrën për të formuar qeverinë e re dhe zgjodhi vlonjatin Mehmet Feridi dhe Hysen Nazëmin të dy kandidatë të pavarur nga Komiteti xhonturk, përkatësisht njëri ministër i jashtëm dhe tjetri ministër i luftës.<sup>1476</sup>

Në takimin e parë të kabinetit të ri, veziri i madh i porsaemëruar u tregoi anëtarëve të tij në mënyrë të kobshme se Komitetit “*Bashkim dhe Përparim*” “nuk u kishin ngelur më shumë se tre a katër ditë jetë”.<sup>1477</sup>

Ai bëri po ashtu të ditur se kabineti i tij nuk do të ishte në shërbim të Komitetit, por të interesit të mbrojtjes së Perandorisë Osmane nga rrënimet që po i vinin nga brenda nga politika jo e mirë e Xhonturqve. Ai erdhi në fuqi me detyrë të përcaktuar, prej të cilave më urgjentja ishte që të bënte paqe me Shqiptarët.<sup>1478</sup>

Kështu, Këshilli i Ministrave, më 24 korrik 1912 kishte formuar komisionin prej tre vetash: Danush be Prishtinës, ish-valiu i Selanikut, gjeneral Sylejman Kolonjës, senator dhe guvernator i Plevlës dhe Esad Pashë Toptani, deputet i Shkodrës. Këta tre Shqiptarë duhej ta hetonin çështjen sa më parë dhe, si thuhej, të krijonin mundësi të pajtimit me Shqiptarët.<sup>1479</sup>

Në udhëzimet qeveritare për Komisionin për Shqiptarët, ndër të tjera, thuhej se Shqiptarët ishin “*pjesa ma e fortë e ma randësore e kombit otoman n’anën e Rumelis*”, kurse Shqipëria, e cila sipas udhëzimeve për këtë Komision, përbëhej prej katër vilajeteve: të Kosovës, Shkodrës, Manastirit dhe të Janinës, ishte “*nji nga pjesët ma të shqueme të ksaj mbetje të madhe*” dhe se kërkesat shqiptare do t’i vendosë “*brenda qarkut të legalitetit e të Kushtetutës*”.<sup>1480</sup>

Këshilli i Ministrave këtë komision e formoi në bazë të kërkesës së Sulltanit, të datës 22 korrik 1912, ku kërkohej “*që t’u epej fund paudhësive e padrejtësive*” në Shqipëri.<sup>1481</sup>

Për ndryshim prej kryengritjes së vitit të kaluar, asaj në Malësinë e Veriut, kur ministri i luftës, Mahmut Shefqet Pasha dhe gjenerali i tij Turgut Pasha, pasi që me mjetet e luftës të kenë shtypur kryengritjen e Shqiptarëve dhe qeveria xhonturke merrte lëvdata pse “vendoste rendin” tek Shqiptarët, këtë herë, Shqiptarët me kryengritjen e tyre të organizuar mirë, të ndërlihdur dhe me kërkesa të qarta politike, e

---

<sup>1476</sup> Gawrych, George: “*Gjysmëhëna dhe shqiponja*”, Tiranë, 2007, faqe 295.

<sup>1477</sup> Po aty, faqe 295.

<sup>1478</sup> Skëndi, Stavro: “*Zgjimi kombëtar shqiptar*”, Tiranë, 2000, faqe 386.

<sup>1479</sup> Po aty, faqe 119.

<sup>1480</sup> Abdylî, Tahir: “*Hasan Prishtina*”, Prishtinë, 2003, faqe 119.

<sup>1481</sup> Nga instruksionet e Kryeministrit për Komisionin qeveritar të dërguar në Kosovë, “*Leka*”, nr. i veçantë, dhe - Abdylî, Tahir: “*Hasan Prishtina*”, Prishtinë, 2003, faqe 119.



cila kishte epiqendrën në Kosovë, por pak nga pak dhe në forma të ndryshme të rezistencës do të përfshijë edhe pjesët e tjera të Shqipërisë, edhe pse ashtu siç pritej, ia kishin dalë që të rrëzonin qeverinë xhonturke, pas pak të detyronin edhe shpërndarjen e parlamentit të dominuar nga Xhonturqit, me çka po i hapej udha një kthese të madhe të përmasave perandorake. Kështu, ata që para katër vitesh kishin sjellë në pushtet Xhonturqit, këtë herë ktheheshin në shkaktarë të rrëzimit të tyre nga pushteti. Ardhja e Komisionit të qeverisë në Prishtinë, duhej t'i jepte përlligje këtij ndryshimi të madh, që ishte fryt i kryengritjes shqiptare të Kosovës.

Por, në Kosovë nuk do të vijë Esad Pashë Toptani. Arsyet e “ikjes nga përgjegjësia” mund të kërkohen se ai ishte pjesëmarrës dhe nënshkrues i Marrëveshjen e Taksimit kur ishte marrë vendimi për kryengritjen shqiptare dhe kërkesën për autonominë e Shqipërisë, ku ai ishte ngarkuar me përgjegjësinë e organizimit të kryengritjes në Shqipërinë e Mesme dhe në vilajetin e Shkodrës, por këtë nuk e kishte bërë,<sup>1482</sup> siç nuk e kishte bërë as Myfid be Libohova, i cili ishte ngarkuar me kryengritjen në Vilajetin e Janinës.<sup>1483</sup>

Këshilli i Ministrave caktoi Rashid Akif Pashën. Por, edhe ky u shtir i sëmurë dhe në vend të tij u caktua Ibrahim Pasha, Shqiptar nga Manastiri, kurse sekretar i komisionit u caktua Avni Gjinali, patriot i çmuar.

Gazi Ahmet Myftar Pasha e orientoi qeverinë drejt një marrëveshje e cila do të arrihej me bisedime me Shqiptarët kryengritës. Komisioni arriti në Prishtinë më 27 korrik 1912, kur tashmë kryengritësit kishin vu nën mbikëqyrje të gjitha qytetet e Kosovës për të hyrë përfundimisht në Prishtinë më 21 korrik pa ndonjë rezistencë të ushtrisë osmane, e cila të shumtën do të dorëzohet. Në rrethanat e këtyre sukseseve të rëndësishme luftarake, ishte e natyrshme që Shqiptarët të përqendroheshin tek kërkesa për shpërndarjen e menjëhershme të parlamentit, si një parakusht për bisedime të mëtutjeshme. Po të mos zbatohet kjo pikë, Shqiptarët do të rifillonin sulmet pas 48 orëve. Ky qe një ultimatum i matur mirë i cili mund të nxirrte në pah raportin e njëmend të forcave në kreun e piramidës së Portës së Larës pas rënies së qeverisë xhonturke dhe emërimit për vezir të madh Gazi Ahmet Myftar Pashës. Paraprakisht, ultimatumit shqiptar do t'i paraprijë takimi i parë i kryengritësve të kryesuar nga Hasan Prishtina me Komisionin të drejtuar nga ma-

---

<sup>1482</sup> Po aty, faqe 119.

<sup>1483</sup> Më gjerësisht rreth mospërbushjes së zotimeve të Marrëveshjes së Taksimit rreth organizimit të kryengritjes gjithëshqiptare nga ana e Esad pashë Toptanit, Myfid bej Libohoves dhe të tjerëve, shih Prishtina, Hasan “Nji shkurtim kujtimesh”, Bari, 1925; Abdyl, Tahir: “*Hasan Prishtina*”, Prishtinë, 2003, Cana, Zekeria: “*Lëvizja kombëtare shqiptare në Kosovë 1908-1912*”, Prishtinë, 1979, faqe 223-231 ; Pllana, Emin: “*Kosova dhe reformat në Turqi*”, Prishtinë, 1978.

reshali Ibrahim Pasha me ç'rast atij nga ana e Hasan Prishtinës iu bënë me dije kërkesat e Shqiptarëve të përmbledhur në këto pika:

- a) Të njihen zyrtarisht kufijtë e Shqipërisë.
- b) Autoritetet civile e ushtarake të jenë të kombësisë shqiptare.
- c) Ushtria Shqiptare të shërbejë në Shqipëri e të jetë komanda prej oficerëve shqiptarë dhe
- d) Veprimet e zyrtarëve në Shqipëri të bëhen në gjuhën shqipe.<sup>1484</sup>

Gjenerali u mundua që kryengritjen e Shqiptarëve ta trajtojë si një lëvizje lokale, që i përkiste vetëm Kosovës, por dështoi përballë qëndrimit të Hasan Prishtinës dhe krerëve të tjerë të kryengritjes, të cilët ia bënë me dije se fjala ishte për lëvizje kombëtare shqiptare. Po të mos ishin disa lëvizje të shkëputura kryengritëse dhe po mos të ishte solidariteti i një pjese të viseve shqiptare me Kryengritjen e Kosovës, sigurisht se mareshali osman mund të kishte të drejtë. Por, Hasan Prishtina, që e dinte fare mirë kurthin e pashait dinak, menjëherë iu përgjigj se Kosova ishte caktuar qëllimisht epiqendër e kryengritjes, siç kishte ndodhur edhe gjatë “Lidhjes Shqiptare të Prizrenit” dhe siç kishte ndodhur ngaherë, ndërsa pjesët e tjera prisnin epilogun, që po dështoi, të ndizet e gjithë Shqipëria përnjëherë.<sup>1485</sup>

Megjithatë, Ibrahim Pasha, tek kërkesa për autonomi, punoi për t'i përçarë Shqiptarët, me arsyetimin se ajo ishte e rrezikshme për fatet e trojeve shqiptare për vetë fatet e kombit shqiptar, në një kohë kur Aleanca Ballkanike po bëhej gati të fillonte veprimet luftarake në rast se Perandoria Osmane do të lejonte autonominë shqiptare. Madje, një çast ai i tha Hasan Prishtinës se kështu po veprohej që të ndaheshin nga Perandoria Osmane, gjë që “*kjo nuk kishte me i pasë hije Shqypnisë me kërkuje këso pikash, pse populli asht muhamedan*”.<sup>1486</sup>

Pasi që do t'i përgjigjej se “*feja nuk ka shka të bajë me komsi (kombësi)*”, Hasan Prishtina, në këtë uverturë të bisedimeve, bëri një sulm me fjalë përvëluese kundër regjimit xhonturk. Numëroi gjithë aktet e dhunës të kryera nga Xhonturqit kundër vendit të tij dhe theksoi shkatërrimet e bëra. Si pikë të fundit përmendi zgjedhjet e sapo kryera. Tha se Shqipëria që një njësi e bashkuar dhe kërkonte shpërndarjen e menjëhershme të parlamentit, sepse nuk kishte mandatin e popullit.<sup>1487</sup>

---

<sup>1484</sup> Prishtina, Hasan: “*Nji shkurtim kujtimesh mbi kryengritjen shqiptare të vjetit 1912*”, Prishtinë, 2009, faqe 30.

<sup>1485</sup> Shih: Prishtina, Hasan: “*Nji shkurtim kujtimesh mbi kryengritjen shqiptare të vjetit 1912*”, Bari, 1925, faqe 30-31.

<sup>1486</sup> Aty, faqe 30.

<sup>1487</sup> Raport nën shifërën: “tepër sekret”, i Tahyt drejtuar Bertcholdit nga Mitrovica, 4 gusht 1912, nr 45 HHStA, PA XIV/39, Albanien XXXIV. Shih edhe Prishtina, Hasan: “*Nji shkurtim kujtimesh...*”, Prishtinë, 2009, faqe, 30.

Ibrahim Pasha, ishte përgjigjur se Sulltani e kishte dërguar Komisionin special të studionte ankesat e Shqiptarëve dhe merrte parasysh kërkesat e tyre të arsyeshme.

Që t'u ikte trysnive që Komisioni qeveritar në forma të ndryshme bënte ndaj krerëve të lëvizjes, veçmas te disa që lëkundeshin dhe, t'u ikte edhe përpjekjeve përçarëse që ato ditë bënin emisarët e ndryshëm serbë dhe diplomatët e tyre në Kosovë (veçmas konsulli Mijoviq në Prishtinë) ndaj disa liderëve shqiptarë me të cilët ata mbanin lidhje dhe do të takohen edhe gjatë kohës së bisedimeve Hasan Prishtina, zhvendosi qendrën e kryengritjes nga Prishtina në Ferizaj dhe ftoi përfaqësuesit nga të gjitha krahinat e Shqipërisë që të vinin në kuvendin kombëtar në Ferizaj.<sup>1488</sup>

Kundruall vendosmërisë së Shqiptarëve, qeveria turke, që tashmë ndodhej në vështirësi parlamentare, u shtrëngua t'i përulej trysnisë shqiptare dhe më 5 gusht 1912, me gjithë dëshpërimin e madh të Komitetit "*Bashkim dhe Përparim*", shpërndau parlamentin me dekret perandorak.

Ky vendim i dha një grusht të rëndë Komitetit deri më atëherë të gjithëfuqishëm "*Bashkim dhe Përparim*" dhe e forcoi pozitën e kabinetit të Gazi Myftar Pashës. Për ironi të fatit, gjatë periudhës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Abdyl Frashëri dhe anëtarë të tjerë të shoqërive shqiptare të bashkimit kishin shprehur dëshirën që Gazi Myftar Ahmet Pasha të ishte në kryet të provincës së vetme të Shqipërisë. Tashmë, tridhjetë vjet më vonë, i njëjti titullar osman drejtonte po atë kabinet, i cili do t'u jepte Shqiptarëve të drejtën e tyre për kombësi.<sup>1489</sup>

Shpërndarja e Parlamentit kënaqi vetëm një pjesë të kryengritësve, ndjekësit e opozitës "*Liri dhe Mirëkuptim*", të ashtuquajturit *itilafistë*, të cilët ishin relativisht të fortë në Kosovë dhe ata vinin nga radhët e turkomanëve. Në Kosovë, megjithatë, fjalën kryesore do ta kenë dy rryma, të cilat kishin interesa të ndryshme: ajo e *autonomistëve*, që drejtohej nga Hasan Prishtina, Nexhip Draga dhe pjesa e aristokratëve Shqiptarë, dhe ajo e *konservatorëve hamidistë*, që ndjekej nga feudalët Shqiptarë dhe një pjesë e parisë së vendit: Isa Boletini, Idriz Seferi, Bajram Curri, Riza bej Gjakova dhe të tjerë. Krahu i autonomistëve ndjehej i forcuar ngaqë ata tashmë kishin përkrahjen e Shqipërisë së Mesme dhe asaj të Jugut, së paku deklarativisht, edhe pse në planin e veprimeve kryengritëse as Jugu e as Shqipëria e Mesme nuk i kishin kryer zotimet e marra në Marrëveshjen e Taksimit, kur Esad Pashë Toptani, ishte zotuar se do të organizonte kryengritjen në Vilajetin e Shkodrës, ndërsa Myfid be Libohova, Azis Pashë Vrioni dhe Syljeman be Vlora ki-

<sup>1488</sup> "Historia e Popullit Shqiptar", Tiranë, 2002, faqe 490.

<sup>1489</sup> Gawrych, George: "Gjysmëhëna dhe shqiponja", Tiranë, 2007, faqe 296.

shin marrë përsipër organizimin e kryengritjes në vilajetin e Manastirit dhe të Janinës.

Përkundër mospërmbushjes së zotimeve të marra në Taksim, thuajse të gjitha viset shqiptare do të ndjehen të lidhur me kryengritjen e Kosovës dhe me kërkesat që do të shtrohen atje. Hetohet se një frymë e përbashkët kombëtare që përshkonte njësoj jugun dhe veriun e vendit. Të kësaj fryme do të jenë edhe kërkesat e përbashkëta politike, të cilat përqendroheshin tek autonomia. Në këtë vazhdë, shënohet se Elbasani dhe Shpati, bashkë me përshëndetjen që i dërgoi kabinetit të ri, përsëriti kërkesat të cilat qenë të përbashkëta për Gegët dhe Toskët, pra mundësia e krijimit të autonomisë shqiptare. Komiteti shqiptar i Fierit kërkoi nga Veziri i Madh që të përfaqësoheshin nga dy delegatë në bisedimet që po zhvilloheshin në Kosovë, mbasi në këto diskutime do të flitej për interesat e përbashkëta midis veriut dhe jugut, gjë që edhe më tutje zvogëlonte mundësitë që të luhej me kartën e përçarjes ndër Shqiptarë në mënyrë që kërkesat e Kosovës të veçoheshin nga ato të pjesëve të tjera, siç kishte ndodhur gjatë kryengritjes së Malësisë së Madhe para një viti.<sup>1490</sup>

Në mbledhjen e Fierit morën pjesë Ismail Qemali, Omer pashë Vrioni, Aziz pashë Vrioni, kolonel Haki Tatzati, Izet bej Zavalani dhe të tjerë. Nga mbledhja iu dërgua një telegram Hasan Prishtinës, me të cilin ai autorizohet që të fliste e të vendoste edhe në emër të Shqipërisë së jugut.<sup>1491</sup>

Mbledhja e Fierit vendosi që Ismail Qemali të mos shkonte në Kosovë, por në Stamboll për të zhvilluar bisedime me qeverinë.<sup>1492</sup>

Mos shkuarja e Ismail Qemalit në Prishtinë me arsyetimin se duhej të bisedonte me qeverinë e Gazi Myhtar Pashës, e cila ishte e interesuar për një marrëveshje me Shqiptarët, nga brenda do t'ia dobësojë pozitën Hasan Prishtinës – ngaqë duhej të bënte kompromise me rrymën e hamitanëve, të cilët në vend të zgjidhjeve politike, siç ishte autonomia, kërkonin kthimin e Sulltan Hamitit - por, ajo do t'i dobësohet edhe në raport me Perandorinë Osmane, ngaqë kjo shkëputje krijoi rrethana të volitshme për thashetheme, intriga dhe madje informata të kurdisura nga qeveria osmane dhe qendrat tjera, të cilat zunë të hidheshin nga anë të ndryshme.

Me to duhej të krijohej përshtypja se kryengritësit nuk ishin as unikë dhe as të vendosur në shumë pikëpamje, veçmas te pakoja e kërkesave që kishin të bënin me autonominë shqiptare, që duhej të ishte prioritet i tyre. Këtë gjendje më së miri e pasqyron një deklaratë e gaztës “Politika” të Beogradit, që qarkulloi me të madhe në

<sup>1490</sup> Raport drejtuar ministrisë së jashtme nga Vlora, në 7 gusht 1912, HHStA, PA XIV/41, Albanien, XXXIV.

<sup>1491</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 490.

<sup>1492</sup> Po aty, faqe 490.

qendrat europaine, ku thuhej se “Ismail Qemali i cili gjendej në Vlorë, e lajmëroi Ministrinë e Ushtrisë se Shqiptarët e Shqipërisë së Jugut me ndërhyrjen e tij kanë heqë dorë nga kërkesat e tyre të posaçme”, pra nga 14 pikshi i Hasan Prishtinës.<sup>1493</sup>

Nga ana tjerë, përballimi me gjendjen, ku ai kishte gjithë përgjegjësinë mbi vete, në raport me Ibrahim Pashën, Hasan Prishtinën e bëri më të përkushtueshëm, gjë që do nxjerrë si lider të vetëm që do të ballafaqohet me njërën ndër sfidat më të mëdha historike të Shqiptarëve në përgjithësi. Në këtë rrugë, megjithatë, Hasan Prishtina, ndonëse vetëm, nga pjesë të ndryshme të Shqipërisë mori mesazhe të shumta përkrahjeje, siç kishte edhe delegatë të ndryshëm, të cilët erdhën për ta mbështetur. Kështu, mbështetje pati nga delegatë nga Manastiri, të cilët shkuan në Prishtinë për të paraqitur atje kërkesat e tyre. Ndërsa Elbasani dërgoi përfaqësuesit e vet, në mes të cilëve qenë patriotët Lef Nosi dhe Ahmet Dakli. Në Prevezë, Leskovik dhe Gjirokastër u zhvilluan mbledhje, ndërsa paria e Janinës i telegrafoi Vezirit të Madh, duke bërë kërkesa të njëjllota si ato të Shqiptarëve të tjerë.<sup>1494</sup>

Pas shumë bisedimesh dhe sheshimesh dhe, duke u ndodhur përballë një gjendje të acaruar ndërkombëtare (ishte në përfundim e sipër Aleanca Ballkanike që po çonte drejt një lufte me pasoja të rënda edhe për Shqipërinë), Hasan Prishtina dhe krerët e tjerët të kryengritjes, për të mënjeluar përçarjet në udhëheqjen shqiptare, paraqiti një program tjetër kërkesash, më të moderuar, që do të ishte më i pranueshëm edhe për Portën e Lartë, e cila po ashtu kishte nevojë për një hapësirë manovrimi edhe në rrethanat kur ishte më se e qartë se Gazi Ahmet Myftar Pasha dhe shumë të tjerë nga kreu qeverisës i Perandorisë e kishin kuptuar se ishte marrëveshja me Shqiptarët dhe plotësimi i kërkesave të tyre ajo që e mbronte Perandorinë Osmane dhe jo e kundërta, siç kishte menduar dhe vepruar Sulltan Hamiti dhesë fundit edhe Xhonturqit. Kjo parashtesë e ekuilibruar dyanshëm, e njohur me emrin “*Katërmbëdhjetë Pikat e Hasan Prishtinës*”, u miratua nga përfaqësuesit e kryengritjes shqiptare në kuvendin e mbajtur në Ferizaj, më 6 gusht dhe iu paraqit palës osmane.<sup>1495</sup>

Para se teksti i Memorandumit t’i dorëzohej Ibrahim Pashës, sipas kërkesës së Isa Boletinit, iu dha për lexim edhe krerëve përfaqësues të serbëve të Kosovës, përkatësisht përfaqësuesve të Serbisë në këtë kuvend, të cilët bënë çmos që të mos fitonte krahu i autonomistëve, meqë Serbia ishte e interesuar që konservativët të

<sup>1493</sup> Shih “*Politika*” - Beograd, më 12 gusht 1912, dhe - Abdyl, Tahir “*Hasan Prishtina*”, Prishtinë 2003, f. 144.

<sup>1494</sup> Halle drejtuar Bertcholdit, Manastir, 8 gusht 1912, nr. 89 dhe 15 gusht 1912, nr 95; Bilinski drejtuar Bertcholdit, Janinë, 15 gusht 1912, nr. 61, të gjitha te HHStA, PA XIV/41, Albanien XXXIV.

<sup>1495</sup> Po aty.

vazhdonin kryengritjen dhe madje të marshonin drejt Selanikut në mënyrë që të dy palët (Shqiptarët dhe Osmanët) të dobësoheshin dhe pastaj Beogradi ta kishte më të lehtë që t'i realizonte aspiratat grabitqare ndaj territoreve shqiptare.<sup>1496</sup>

Të ballafaquar me këto rreziqe dhe me përcaktimin se marrëveshja midis Shqiptarëve dhe qeverisë osmane ishte në interes të dyanshëm, më 9 gusht 1912, Hasan Prishtina bashkë me udhëheqjen e kryengritësve të Kosovës, që tashmë kishin mandatin thuajse të të gjithë viseve shqiptare, u takua me Ibrahim Pashën. Hasan Prishtina paraqiti katërmëdhjetë kërkesat, që ishin:

1. *Zbatimi i drejtësisë në disa zona të Shqipërisë sipas “ligjit të maleve”;*
2. *Kryerja e shërbimit ushtarak në Rumeli, përveçse në rast lufte apo në situatat të veçanta brenda vendit;*
3. *Kthimi i armëve të konfiskuara;*
4. *Emërimi i zyrtarëve që e njihnin gjuhën dhe zakonet e krahinës;*
5. *Ndërtimi i liceve dhe shkollave bujqësore në kryeqytetet krahinore të Janinës, Shkodrës, Manastirit dhe Kosovës në të cilët mësimdhënia do të bëhej në gjuhën shqipe;*
6. *Ndërtimi i më shumë shkollave fillore;*
7. *Dhënia e lirisë për të hapur shkolla private;*
8. *Futja e gjuhës amtare në shkollat fillore, të mesme apo ato të cikleve më të larta;*
9. *Përmirësimi dhe zgjerimi i rrugëve;*
10. *Vendosja e nahijeve shtesë;*
11. *Nderim dhe respekt ndaj parimeve morale të fesë islame dhe ligjeve kushtetuese të Perandorisë;*
12. *Hedhja në gjyq e kabineteve qeveritare të Ibrahim Hakiut dhe Said Pashës;*
13. *Një amnisti e përgjithshme, dhe*
14. *Pagesa e dëmshpërblimeve për pronat e dëmtuara.*<sup>1497</sup>

Si shihet këtu nuk ishte përmendur çështja e autonomisë, pikë kjo kryesore e dalë në Kuvendin e Juniku dhe, në forma të ndryshme, kishte paraqitur trungun e kërkesave politike të Shqiptarëve që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Kundrimi i pikave veç e veç, krahas aspekteve të përgjithshme që lidheshin me nevojën e ruajtjes së Perandorisë Osmane si një mburojë që Shqiptarëve aktualisht u shërbente për t'u

<sup>1496</sup> Prishtina, Hasan: “Nji shkurtim kujtimesh”, Prishtinë, 2009, faqe 32-33.

<sup>1497</sup> Gawrych, George: “Gjysmëhëna dhe shqiponja”, Tiranë, 2007, faqe 298.

mbrojtur nga pretendimet e fqinjëve, nxirrte në pah edhe interesat e rrymave brenda Shqiptarëve – konservatorëve, që kërkonin kthimin e privilegjeve dhe kanunin, aristokracisë dhe intelektualëve, që kërkonin autonomi brenda një shteti modern dhe të opozitarëve nga radhët e *veltilafëve* (partia *Liri dhe Marrëveshje*).

Kërkesa për gjuhën shqipe si gjuhë arsimit dhe gjuhë e administratës, arsimit i detyruar fillor dhe i mesëm nacionalizmit shqiptar ia kthenin atutë kryesore me të cilat shqiptarëve u lejohej statusi i kombësisë me çka krijoheshin kushtet për autonomi administrative dhe politike në përbërje të Perandorisë Osmane.

Qeveria osmane, nuk do t'i përgjigjet brenda dyzet e tetë orëve Memorandumit të Katërbëdhjetë Pikave të Shqiptarëve. Sjellja e Ibrahim Pashës lente përshtypje se ai edhe më tutje kërkonte të përçante Shqiptarët, ani pse në parim qeveria e Gazi Myftar Ahmet Pashës nuk ishte e interesuar për një çrregullim midis Shqiptarëve, ngaqë kishte frikën se ashtu mund të fitonin krah forcat konservatore midis tyre, të cilat edhe ashtu ishin në pakicë krahasuar me autonomistët dhe opozitarët, por që trimëroheshin me të madhe nga Serbia dhe aleatët e saj ballkanikë, të cilët bënë çmos që midis Shqiptarëve dhe qeverisë të mos ketë marrëveshje por thellim të mëtutjeshëm të krizës. Kjo bëri që disa nga udhëheqësit e kryengritjes të kërkonin që të marshohej për në Shkup dhe atje të fillohej me ultimatume edhe më të ashpra, të cilat mund të shkonin edhe te vazhdimi i kryengritjes me kërkesa të tjera edhe më radikale. Isa Boletini, Idriz Seferi, Bajram Curri dhe, mbi të gjitha, Riza bej Gjakova u bashkuan në mes të tyre dhe urdhëruan forcat të përparonin drejt Shkupit, me arsyetimin se “njerëzit e tyre nuk mund të prisnin më gjatë”.

Midis 12 dhe 15 gushtit Shqiptarët hynë në Shkup pa hasur në ndonjë rezistencë. Grupi i parë i kryengritëseve që hyri në këtë qytet ishte ai i Barjam Daklanit dhe Zefit të Vogël, të cilët shpалosën flamurin kombëtar shqiptar.<sup>1498</sup>

I fundit hyri Bajram Curri me forcat kryesore të kryengritjes me rreth 6000 veta. Sapo hyri në Shkup Bajram Curri hapi burgun dhe liroi qindra të burgosur të pranguar. Vlerësohej se në Shkup gjatë tri ditëve hynë rreth 30 mijë Shqiptarë, të cilët ishin të qetë. Disa njësi u drejtuan kah Tetova, Kumanova dhe Presheva, ku po ashtu hynë pa kurrfarë rezistence. Ushtria osmane mbeti në kazerma dhe nuk iu kundërvu marshimit të Shqiptarëve në Shkup dhe qytetet tjera përreth. Kishte urdhër të prerë që të mos u nënshtrohej provokimeve.<sup>1499</sup>

Qëndrimi i përmbajtur i ushtrisë osmane në Shkup dhe pjesët tjera me rastin e depërtimit të kryengritësve shqiptarë në qytete, flet qartë për përcaktimin e Gazi

<sup>1498</sup> “*Historia popullit shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 491.

<sup>1499</sup> Cana, Zekeria: “*Lëvizja kombëtare shqiptare e Kosovës 1908-1912*”, Prishtinë 1979, faqe 238.

Myftar Ahmet Pashës për një marrëveshje me Shqiptarët dhe për tryshninë, që duhej t'u bëhej kundërshtarëve që asaj i kundërviheshin, ta pranonin sa më parë.

E përballur me një zhvillim të ri, siç ishte hyrja e kryengritësve shqiptarë në Shkup, si dhe mundësia që një krah i kryengritësve (Isa Boletini, Idriz Seferi, Bajram Curri dhe Riza bej Gjakova) të gjenin shkas që të vazhdonin edhe më tutje kryengritjen dhe madje, si dyshohej, të marshonin drejt Selanikut për ta kthyer Sulltan Hamitin në fron, qeveria osmane, më 18 gusht deklaroi se pranonte Memorandumin e Katërbëdhjetë Pikave të Shqiptarëve, me përjashtim të dy kërkesave:

- kthimit të armëve të luftës dhe
- hedhjes në gjyq të pjesëtarëve të kabineteve të Xhonturke të Haki Pashës dhe Said Pashës,

U tha se miratimi i këtyre pikave ishte në kompetencë të Parlamentit.<sup>1500</sup>

Ka shumë shenja që Gazi Myftar Ahmet Pasha këtë çështje ta ketë biseduar me diplomatët austro-hungarezë në Stamboll dhe me ta të jetë marrë vesh për projektin e autonomisë shqiptare. Qëndrimi i Vjenës rreth kësaj marrëveshje, si dhe tërheqja energjike e vërejtjes Ruisë, por edhe vendeve të Aleancës Ballkanike se nuk do të pranohen rezultatet e luftës, por do të jetë politika që do të vendosë për fatin e Ballkanit, lenë qartë për të kuptuar se Memorandumi i Katërbëdhjetë Pikave të Shkupit kishte pajtimin Vjenë-Stamboll, e me këtë edhe të Lidhjes Trepalëshe. Sepse, pa të pavarësia e Shqipërisë dhe shteti shqiptar që do të dalë nga ajo, nuk do të kishte përkrahjen e Fuqive të Mëdha në Konferencën e Ambasadorëve në Londër e as që do të pranohej.<sup>1501</sup>

Udhëheqja e kryengritjes në Kosovë deklaroi se pranonte këtë marrëveshje dhe shpalli ndërprerjen e kryengritjes. Hasan Prishtina njoftoi gjithashtu përfaqësuesit e Shqipërisë së Mesme dhe të asaj të Jugut që të ndërprisnin veprimet e armatosura kundër trupave qeveritare, edhe pse ato nuk kishin qenë aq shqetësuese për Perandorinë Osmane. Ai njoftonte në këtë rast se kërkesat e kryengritësve u pranuan për të gjithë Shqipërinë. Kështu, në këto rrethana kryengritja u ndërpre.<sup>1502</sup>

Shqiptarët kishin arritur një fitore të rëndësishme historike dhe mund të shprejonin se përpara kishin një terren të hapur, ku me pranimin e të drejtës së kombësisë (*hukuk-u kavimiyet*), e cila u siguronte zhvillimin e lirë të identitetit kombëtar, u ishin hapur dyert ndërtimit të autonomisë, apo asaj që tashmë nga fqinjët e

---

<sup>1500</sup> Po aty, faqe 494.

<sup>1501</sup> Më gjerësisht shih: Buxhovi, Jusuf: "Nga Shqipëria Osmane te Shqipëria Europiane", Prishtinë, 2010.

<sup>1502</sup> Abdyli, Tahir: "Hasan Prishtina", Prishtinë, 2003, faqe 155.



Shqiptarëve (Serbët, Grekëvt, Malaziasit dhe Bullgarët) me brengosje shihej si “Shqipëri Osmane”, të cilën, sipas tyre, duhej parandaluar me çdo kusht.

## LUFTA BALLKANIKE DHE SHPALLJA E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË

Më shqetësuese se sa vetë përmbajtja e marrëveshjes së kryengritësve shqiptarë (Katërmëdhjetë Pikëshit të Hasan Prishtinës) me qeverinë osmane për fqinjët e Shqiptarëve, por jo vetëm për ta, ishte ajo se Shqiptarët, me anën e trysnisë dhe në përputhje me interesat e veta, kishin arritur atë shkallë që të ndikojnë ose ndryshojnë kahun e politikës së Perandorisë Osmane. Kjo ishte treguar me rastin e Revolucionit Xhonturk 1908 kur ata, me ultimatumin e dalë nga Kuvendi i Ferizajt, ishin sjellë në pushtet dhe kjo ishte treguar edhe me kryengritjen e fundit, kur Shqiptarët kishin rrëzuar qeverisjen xhonturke si dhe kishin detyruar shpërndarjen e parlamentit të dominuar prej Komitetit “*Bashkim dhe Përparim*” vetëm pak ditë pasi ai ishte zgjedhur.

Ky zhvillim, në të vërtetë, ia kishte përcaktuar kahun krizës në të cilën ishte përfshirë Perandoria Osmane nga brenda dhe nga jashtë njëherësh, sepse marrëveshja me Shqiptarët e arritur në Shkup (Katërmëdhjetë Pikshi i Hasan Prishtinës) kishte përshpejtuar shpërthimin e Luftës së Parë Ballkanike, e filluar nga Aleanca Ballkanike (Serbia, Mali i Zi, Greqia dhe Bullgaria), të cilat për shkak të aspiratave që kishin në rajon, nuk donin që Shqipëria të bashkohej nën mbrojtjen e sovranitetit osman. Sepse, këto vende tashmë e kishin të qartë se Shqiptarët politikisht ishin pjekur, siç ishin faktorizuar nga brenda dhe nga jashtë, gjë që nuk kishte si të mos përfundonte ndryshe pos me një shtet të pavarur shqiptar pa marrë parasysh rrugët nëpër të cilat do të kalonte. Për vendet fqinje, Katërmëdhjetë Pikshi i Hasan Prishtinë, edhe pse aty nuk përmendej fjala autonomi, fliste qartë për shfaqjen e pashmangshme të një entiteti shtetëror shqiptar në hapësirën e tij etnike, që duhej penguar sa më parë edhe me luftë. Andaj, ia vlente që kundër tij të hyhej në luftë para se të bëhej vonë. Lufta, pra, ishte e pashmangshme.

Në të vërtetë, lëvizja aktive e vendeve ballkanike (Serbisë, Malit të Zi, Greqisë dhe Bullgarisë) kundër autonomisë së mundshme shqiptare në kuadër të Perandorisë Osmane, që ajo të pengohej me mjetet e luftës së përbashkët, kishte filluar sapo Italia ishte futur në luftë kundër Perandorisë Osmane në Tripoli. Serbia dhe

Rusia nisën t'i ripërtërinin përpjekjet e tyre për një aleancës serbo-bullgare, të bindur se sundimit osman në Ballkan po i vinte fundit.<sup>1503</sup>

Mbasi shtetet ballkanike kërkonin luftën kundër Perandorisë Osmane dhe toka që lakmonin ata që Shqipëria, kërkesat e përsëritura të Shqiptarëve i kishin tronditur thellësisht se me një marrëveshje me Portën e Lartë, të sugjeruar nga Vjena, do t'u dilnin nga dora. Andaj, paqja midis Perandorisë Osmane dhe Shqiptarëve si dhe marrëveshjet e tyre shiheshin si të dëmshme dhe të rrezikshme, ngaqë ndryshonte raportin e forcave në rajon dhe më gjerë.

Shqetësimi i shteteve ballkanike nga autonomia shqiptare nisi të manifestohej më hapur dhe sheshit kur dolën në pah përmasat e njëmendta të Kryengritës së Kosovës si dhe solidarizimi me të në pjesët tjera të Shqipërisë pa marrë parasysh qëndrimin e tyre pasiv. I dërguari bullgar pranë Portës, Sarafov, i tha Pallavicinit (ambasadorit vjenez në Stamboll) se lajmet rreth një bashkimi të mundshëm të katër vilajeteve shqiptare në një njësi administrative autonome qenë tronditëse.

*“Një masë e tillë, do t'i jepte elementit shqiptar një dominim absolut dhe do të rrezikonte interesat jetësore të elementeve të tjerë bullgarë, serbë dhe grekë – që banonin në ato vilajete”.*<sup>1504</sup>

Kjo gjendje, siç u zhvillua dhe paralajmërimet se epilogu “pajtuës” i marrëveshjes midis qeverisë osmane dhe Shqiptarëve rreth autonomisë së tyre të brendshme ua jepte dritën e gjelbër fqinjëve të Shqiptarëve që të hynin në luftë me Perandorinë Osmane, e shqetësuan seriozisht Austro-Hungarinë. Vjena druante se gjendja nuk mund të mbahej më nën mbikëqyrje e as t'i përcaktoheshin kornizat zhvillimeve.

Nuk mund të thuhet se Vjena nuk ishte e përgatitur për këtë zhvillim, ve çmas kur dihej se ajo mbështeste qeverinë e Gazi Ahmet Myhtar Pashës, e cila kishte vendosur një farë qetësie në krizën e brendshme të Perandorisë Osmane dhe po përpiqej me anën e lëshimeve substanciale, të cilat shkonin edhe deri tek planet për pranimin e autonomisë së tyre, t'i jepte fund revoltës së Shqiptarëve. Në këtë rrugë, e cila paraqiste një kthesë të rëndësishme por shumë sfiduese njëherësh, Gazi Ahmet Myhtar Pasha kishte ardhur te përfundimi se qëndrimi pajtuës me Shqiptarët dhe përmbushja e kërkesave të tyre, qofshin edhe ato që çonin kah autonomia politike dhe administrative, e cila kundërshtohej nga të gjitha anët, shkonte në dobi të stabilitetit të Perandorisë, por edhe të mbetjes së saj në pjesën europiane, në një formë tjetër, jashtë ultimatumave dhe kërcënimeve që i bëheshin nga vendet sllave, të cilat kishin projek-

<sup>1503</sup> E. G. Helmreich: *“The Diplomacy of the Balkan Wars, 1912-1913”*, Kembrixh, 1938, faqe 47 dhe Skëndi, Stavro: *“Zgjimi Kombëtar shqiptar”*, Tiranë, 2000, faqe 402.

<sup>1504</sup> Raport i Pavallacini drejtuar Bertcholdit, 5 gusht 1912, nr. 66, HHStA, PA/39 Albanien XXXIV.

tuar copëtimin e tokave shqiptare, formë kjo që Shqiptarët në vend të digës kundër pansllavizmit të shfaqeshin edhe si “urë pajtuese midis qytetërimeve”, e cila si e tillë do të mund të mbrohej, por edhe të pranohej shumë më lehtë, gjë që për këtë ajo kishte mbështetjen e Austro-Hungarisë, të Gjermanisë dhe të Italisë.<sup>1505</sup>

Drejt këtij kapërcimi të rëndësishëm, Vjena ishte e interesuar që statusi i Shqiptarëve të kalonte fillimisht nëpërmes njohjes së kombësisë së tyre, që ajo, hap pas hapi të fitojë edhe ekuivalencën politike, kah autonomia. Kështu që Berchtoldi (Berhtoldi) doli me qëndrimin se Fuqitë e Mëdha duhej të ushtronin trysni te vendet ballkanike që marrëveshja e Shqiptarëve me Portën e Lartë për decentralizim të brendshëm dhe për drejta të barabarta të gjuhës shqipe, të mos kundërshtohet, meqë ashtu ruhej *status quo*.<sup>1506</sup>

Rusia mbeti e pakënaqur me qëndrimin e Vjenës, meqë e kuptonte se çfarë synohej nga kjo, veçmas nga “*decentralizimi i brendshëm*” dhe “të drejtat e barabarta të gjuhës shqipe”, andaj i shprehu Italisë pikëpamjen “*se objektivi real i Berchtoldit që krijimi i një Shqipërie të sunduar nga Monarkia e Dyfishtë*”.<sup>1507</sup>

Se një Shqipëri ashtu si e shihte Rusia do të ishte nën ndikimin e madh të Austro-Hungarisë - por jo e sunduar nga monarkia e dyfishtë, sepse për këtë as që kishte nevojë meqë kjo hapte rivalitetin e panevojshëm me italianët që i takonin të njëjtit pakt - këtu nuk kishte kurrfarë dyshimi. Këtë madje, e kërkonin edhe një pjesë e mirë e intelektualëve shqiptarë, të cilët e dinin se në mungesë të fazës kalimtare, pra të autonomive, nëpër të cilat kishin kaluar thuajse të gjitha vendet sllavo-ortodokse që ishin çliruar nga sundimi osman (Serbia me 27 vjet autonomi; Rumania me 7 vjet autonomi; Bullgaria me 30 vjet autonomi, Greqia me 12 vjet mbikëqyrje autonome), atyre doemos u duhej një fuqi e madhe europiane e qytetëruar që do t’ua “kompensoje” kohën e autonomisë që në rrethanat e reja nuk e kishin.

Krahas këtyre kundërimeve të cilat shfaqeshin të mundshme tek çështja, e cila me organizimin e Kryengritjes së Kosovës dhe marrëveshjes së Katërmëdhjetë Pikeshit të Hasan Prishtinës me Ibrahim Pashën, kur do të rrëzohet sundimi xhonturk, kundërshtari më i madh i fuqive europiane, tashmë ishte faktorizuar së tepër-

---

<sup>1505</sup> Më gjerësisht rreth raporteve në prag të luftërave ballkanike dhe skenarëve të ndryshëm shih: Čović, J: “*Odnosi Srbije i Austrougarske u XX veku*”, Beograd 1936; Šeredan, A: “*Balkanski rat i austriska intervencija*”, Niš, 1913; Tejlor, A: “*Borba za prevlast u Evropi 1848-1918*”, Sarajevo 1968; Tucović, Dimitrije: “*Srbija i Arbanija*”, Beograd-Zagreb 1945; Puto, Arben: “*Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914*”, Tiranë 1978.

<sup>1506</sup> Kr. T. v. Sosnonsky: “*Die Balkanpolitik Österreich-Ungarns seit 1866*”. Vëllimi II. Stuttgart dhe Berlin, 1914, faqe 276-281.

<sup>1507</sup> Salvatorelli, L: “*La Triplice Alleanza, storia diplomatica, 1887-1912*”, Milano, 1939, faqe 445-446, sipas Skëndi, Stavro: “*Zgjimi kombëtar shqiptar*”, Tiranë, 2000, faqe 404.

mi dhe shfaqet i pakalueshëm. Kështu që, krahas përpjekjeve që të fusë të çara midis vendeve të përfshira në Paktin e Trefishtë, ku ishte më se e qartë se tashmë Shqiptarët kishin mbështetësit e pashmangshëm, Rusia vazhdoi që t'u kundërvihet qëllimeve të Vjenës për autonominë e mundshme shqiptare përbrenda Perandorisë Osmane qysh kur ajo do të shfaqej si mundësi e vetme që mund ta ruante *status quo-n* në Ballkan. Si kundërpërgjigje këtij opsioni ishte nxitja e traktateve midis vendeve ballkanike: së pari serbo-bullgar, më 13 mars 1912; pastaj i bullgarëve dhe Grekëve, më 29 maj 1912 dhe i fundit midis Serbisë dhe Malit të Zi, më 6 tetor 1912, dy ditë para se Mali i Zi t'i shpallë luftë Perandorisë Osmane.<sup>1508</sup>

Pakti midis Serbisë dhe Bullgarisë për Rusinë dhe planet e saj që të përfitonte nga lufta ballkanike që ishte në prag, ishte më i rëndësishmi, sepse Rusia kështu krijonte hegjemoninë në Ballkan të mbështetur mbi platformën sllavo-ortodokse, ku fjala e saj pastaj do të peshonte së tepërmi kur të arrinte shkatërrimi i Perandorisë Osmane.

Në të vërtetë, pakti serbo-bullgar, krahas çështjeve të njohura, përmbante edhe një shtojcë të fshehtë, sipas të cilës Bullgaria i njihte Serbisë jo vetëm tokat me popullsi serbe, por edhe aneksimin e tokave shqiptare në veri e në perëndim të Bjeshkëve të Sharrit (Shqipërinë e Mesme, Verior dhe Verilindore). Kurse Serbia i njihte Bullgarisë tokat në lindje të Rodopit dhe të lumit Struma. Territori midis Bjeshkëve të Sharrit, lumit Struma dhe liqenit të Ohrit, me qytetet kryesore Dibër, Kërçovë, Gostivar, Manastir, Tetovë, Kumanovë dhe Shkup, u quajtën “zonë e diskutueshme” dhe si arbitër për zgjidhjen e kësaj çështje u caktua cari i Rusisë.<sup>1509</sup>

Pakti i Serbisë me Malin e Zi, lidhur dy ditë para se Mali i Zi t'i shpallë luftë Perandorisë Osmane, ishte më shumë çështje formale, meqë midis Cetinës dhe Beogradit që nga koha e asaj që shfaqej artificialisht si krizë e Maqedonisë (1903), të dy vendet ishin pajtuar që Mali i Zi të shtrihej në Shkodër dhe Malësinë e veriut, duke përfshirë këtu edhe pjesën e Dukagjinit nga Peja deri në Gjakovë. Serbia do të merrte pjesën kryesore të Vilajetit të Kosovës dhe më shumë se gjysmën e vilajetit të Manastirit. E rëndësishme, në këtë pakt ishte roli që Mali i Zi duhej të luante në përfshirjen e Shqiptarëve katolikë në luftë me Osmanët për interesat e veta. Cetina tashmë kishte shumë aleatë midis fiseve shqiptare katolike nga Malësia e Madhe e deri

---

<sup>1508</sup> Rreth Aleancës Ballkanike shih: Ratković, B: “Srbija i Crna Gora u Balkanskim ratovima 1912-1914“, Beograd 1972; Stanojević, S: „Srpsko-turksi rat 1912 godine“, Beograd 1928.

<sup>1509</sup> “Historia e Popullit Shqiptar”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2000, faqe 492.

në Podgoricë. Ndër ta dallohej Sokol Baci, i cili haptas ishte vu në anën e malaziasve.<sup>1510</sup>

E mbështetur nga Rusia, Serbia vazhdoi drejtpërdrejt trysninë ndaj Perandorisë Osmane që të mos pranonte kërkesat e Shqiptarëve për autonomi. Por, edhe Beogradi, i cili kishte armatosur disa nga feudalët Shqiptarë dhe u kishte derdhur lira nëpër qese, duke i trimëruar që të lëviznin kundër Perandorisë Osmane me “ndihmën vëllazërore të serbëve” me të cilët “do të ndanin frytet e lirisë bashkarisht”, disa herë do t’i drejtojë protesta Stambollit, që në vend se të bisedonte me Shqiptarët, të përdorte gjithë forcën ushtarake kundër kryengritësve, të cilët i quante “agjentë të Austro-Hungarisë”, të cilët “luftonin që t’ia fusnin thikën Perandorisë, e me këtë edhe rajonit, duke e kthyer atë në feud gjerman”.<sup>1511</sup>

Beogradi, paralajmëroi qeverinë osmane që, në rast se do të plotësoheshin kërkesat e Shqiptarëve, nuk do të mund të shmangeshin tronditjet e reja, shumë të rrezikshme, në radhë të parë për Perandorinë Osmane. Po ashtu, Beogradi dhe Sofja kërkuan me këmbëngulje nga Rusia dhe Anglia që të ndërhynin vendosmërisht kundër njohjes së autonomisë së Shqiptarëve.<sup>1512</sup>

Kërcënimet e Serbisë si dhe pakënaqësia e Ruisë rreth marrëveshjes me Shqiptarët, e detyruan Qeverinë Osmane që të merrte masa qetësuese, duke pohuar se ato që do t’u jepeshin Shqiptarëve do të shtriheshin edhe te popujt joshqiptar të vilajeteve të Kosovës, të Manastirit dhe të Janinës. Madje, në fillim të muajit shtator, Ministria e Jashtme e Qeverisë Osmane, udhëzoi përfaqësuesit e saj diplomatikë që t’u shmangeshin bisedave rreth propozimit të Berhtoldit rreth masave për decentralizimin e krahinave evropiane të Perandorisë Osmane dhe të njohjes së të drejtës së Shqiptarëve si komb i barabartë me të tjerët, të deklaropin në mënyrë të prerë se Porta e quante problemin shqiptar çështje të saj të brendshme.

Kjo nuk i kënaqi aspak shtetet ballkanike. Madje, ato nuk treguan kurrfarë interesimi as për vendimin e qeverisë osmane të 24 shtatorit me të cilën “privilegjet” që u ishin njohur Shqiptarëve shtriheshin edhe mbi popullsitë joshqiptare të vilajeteve të Rumelisë. Sepse, ruleti ballkanik kundër Shqiptarëve dhe të drejtës që të kenë shtetin e tyre, i përkrahur nga Rusia, tashmë ishte bërë gati dhe ai kërkonte “shkasin” për të filluar. Perandoria Osmane tashmë këtë e dinte, por për ironi të fatit, shpresonte që këtë herë, do të jenë pikërisht Shqiptarët dhe hesapi me ta, që

---

<sup>1510</sup> Ratković, B: “*Srbija i Crna Gora u Balkanskim ratovima 1912-1914*”.

<sup>1511</sup> Më gjerësisht rreth propagandës serbe në prak të luftërave ballkanike dhe arsenalit të saj antishqiptar, shih: Perunović, Branko “*Pisma srpskih konzula sa Prištine*”, Beograd, 1985.

<sup>1512</sup> Po aty, faqe 502.

do të merren në mbrojtje nga fuqitë e tjera europiane (veçmas nga vendet e boshtit trepalësh: Austro-Hungaria dhe Gjermania), që do ta shpëtojnë!

Në fund të shtatorit Perandoria Osmane dhe shtetet ballkanike bënë mobilizimin e ushtrive të veta. Mali i Zi urdhëroi mobilizim të përgjithshëm më 30 shtator. Bullgaria e bëri këtë më 1 tetor, ndërsa Serbia dy ditë më vonë. Duke parë se lufta tashmë ishte e pashmangshme, përkundër dallimeve në qëndrime, mbikëqyrësit kryesor të Ballkanit, Austro-Hungaria dhe Rusia, më 7 shtator deklarorin në emër të Fuqive të Mëdha që, në rast lufte ndërmjet Perandorisë Osmane dhe shteteve ballkanike, në mbarim të konfliktit, fuqitë nuk do të lejonin asnjë ndryshim të *status quo-së* territoriale në Ballkan.

Në një kohë kur përfundimi i luftës nuk dihej, Vjena synonte, me këtë deklaratë, të pengonte zgjerimin e shteteve ballkanike në kurriz të Perandorisë Osmane, ndërsa Rusia të siguronte mbrojtjen e aleatëve të vet ballkanikë në rast disfate.<sup>1513</sup>

Të njëjtën deklaratë Vjena do t'ia përsërisë edhe Ismail Qemalit jgatë takimit të tij në Budapest më 17 nëntor, kur ministri i jashtëm vjenez Berhtoldi e siguroi se “*territoret e pushtuara shqiptare do t'i nënshtrohen shqyrtimit ndërkombëtar*”.<sup>1514</sup>

Ishte kjo një gjë e ditur, që në ato rrethana lente qartë për të kuptuar dy gjëra që për Shqiptarët, megjithatë, do të jenë shpresëdhënëse dhe domethënëse:

*e para* - se Shqipëria dhe hapësira e saj do të “*konsiderohet territor i pushuar*”, dhe

*e dyta* - se “*do t'i nënshtrohen shqyrtimit ndërkombëtar*”.

Çështja e parë, kishte rëndësi të madhe, sepse bënte të ditur se lufta e shteteve ballkanike kundër Perandorisë Osmane, nuk do të konsiderohet “*luftë çlirimtare*”, siç propagohej me të madhe nga Serbia, Mali i Zi, Greqia dhe Bullgaria, por ajo do të jetë “*luftë pushtuese*”, që do të thotë se nuk “*çliroheshin tokat serbe*”, apo “*tokat malaziasë*”, apo “*tokat greke*” dhe “*tokat bullgare*”, siç shpreheshin këto shtete, të cilat i jepnin vetit të drejtë që në emër “*të kësaj të drejte*” të copëtonin mbetjen e Perandorisë Osmane në Ballkan, që kryesisht shtrihej në katër vilajetet shqiptare, ku kishte edhe popullsi joshqiptar, por me pakicë.

Edhe çështja e dytë, po ashtu kishte rëndësi të madhe për Shqiptarët dhe fatin e tyre, meqë konfirmonte atë që tashmë dihej, që Vjena dhe të tjerët e kishin thënë sa e sa herë se thyerjet e njëanshme të *status quo-s*, së pari merreshin si veprime kundër marrëveshjeve ndërkombëtare, pavarësisht rezultateve, dhe se, pashmang-

<sup>1513</sup> Kr. T. v. Sosnonsky: “*Die Balkanpolitik Österreich-Ungarns seit 1866*”. Vëllimi II. Stuttgart dhe Berlin, 1914, faqe 276-281.

<sup>1514</sup> Buxhovi, Jusuf: “*Kthesa historike 3*”, Prishtinë, 2010, faqe 200.

shëm kalonin nëpër “tryezën e gjelbër”, pra i nënshtroheshin shqyrtimit ndërkom-bëtar. Që do të thotë se lufta nuk do t’ia përcaktonte kahun politikës, por politika do t’ia përcaktonte asaj fatin. Për popujt si Shqiptarët, të cilët gjykuar sipas planeve të fqinjëve të tyre ata tashmë ishin futur në listën e “të zhdukurve”, uvertura e luftës, paraqiste mundësinë e vetme që të gjejnë shpëtimtarin nga radhët e fuqive të mëdha, që këtë mund ta bëjnë, natyrisht në përputhje me interesat e tyre.

Pavarësisht qëndrimit të Vjenës dhe të Rosisë, lufta ballkanike filloi më 8 tetor, kur ushtria e Malit të Zi, pasi që të ketë nisur veprimet luftarake në drejtim të kufirit shqiptar kah Tuzi në drejtim të Shkodrës dhe në veri në drejtim të Plavës dhe të Gucisë, i shpalli luftë Perandorisë Osmane. Më 17 tetor në luftë hyri edhe Serbia e Bullgaria. Dhe një ditë më vonë edhe Greqia.

Duhet theksuar se Mali i Zi dhe Serbia, sapo të hynë në luftë do t’u drejtohen Shqiptarëve me “*thirrje vëllazërore*”, që t’u bashkoheshin, sepse ajo luftë, sipas tyre, sillte liri edhe për ta.

Mbreti Nikolla i Malit të Zi luftën kundër Perandorisë Osmane e nisi me futjen e njërive shqiptare në vijën e parë të fronteve kah Shkodra dhe kah Kollashini për në Pejë. Mali i Zi kishte nën armë mbi 6 mijë Shqiptarë katolikë të Malësisë së madhe dhe të Mbishkodrës, të cilëve u premtoi se do të fitonin një Shqipëri autonome. Malësorëve, madje, deri në prag të luftës, iu la edhe flamuri kombëtar shqiptar, por çastin që do të fillojë lufta dhe shumë nga pjesët shqiptare edhe në saje të luftës së shqiptarëve të përfshirë në armatën e Cetinës, ranë në dorë të malaziasve, në vend të flamurit shqiptar do të ngrihet ai i Malit të Zi.<sup>1515</sup>

Malësorët Shqiptarë, që kishin marrë pjesë aktive në këtë luftë krahas ushtrive malaziasve, shpejt do të shohin mashtrimin, por atëherë do të jetë vonë. Ngjashëm do të ndodhë edhe me njësitë e Shqiptarëve që morën pjesë në luftimet në drejtim të Pejës. Ushtria malaziasve shqiptarët i futi në vijën e parë të luftimeve. Shumë prej tyre, kur marrin vesh se nuk luftonin kundër Osmanëve, por kundër Shqiptarëve të Kosovës, dezertuan. Brigada e Vasojeviqit, kur depërtoi në Dukagjin, në radhët e veta kishte mbi një mijë malësorë. Ata u detyruan të marrin pjesë në terrorin që do të ushtrojë ushtria e Malit të Zi kundër shqiptarëve, veçmas pasi pushtoi Pejën e Gjakovën.

Edhe mbreti serb Pjetër, në manifestin që shpalli në fillim të fushatës ushtarake serbe, deklaronte në mënyrë demagogjike se do t’u sillte edhe Shqiptarëve lirinë, vëllazërinë dhe barazinë. Ditën që ushtritë serbe sulmuan Merdarin, komandanti i

---

<sup>1515</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 504.

forcave serbe gjenerali Bozhidar Jakoviq do t'u drejtojë një proklamatë Shqiptarëve me titullin simbolik dhe me shkronja cirilike “*T’ton fiseve n Shqipni – or vazni*”.<sup>1516</sup>

Këto dhe proklamatat e ngjashme bënin me dije për gjendjen tepër të rëndë dhe tragjike në të cilën ndodheshin shqiptarët, kur ushtritë osmane nuk ishin në gjendje që t'i mbronin (meqë ato të shumtën po largoheshin nga frontet dhe po rigrupohe-  
shin në dy drejtime për t'u tërhequr më sa më pak humbje), ndërkohë që atyre u binte barra ta bënin këtë, paçka se lufta për mbrojtjen e trojeve të tyre njëherësh i ballafaqonte me hipotekën e përkrahësve të pushtuesve (në këtë rast Osmanëve) dhe kundërshtar të “çlirimtarëve” (Aleancës Ballkanike që luftonte Osmanët).

Në këto rrethana, që të gjitha shtresave shqiptare u binte përgjegjësia e qënd-  
rimit që duhej mbajtur në luftën ballkanike në mënyrë që të shpëtohej Shqipëria

---

<sup>1516</sup> Teksti i plotë i proklamatës i shkruar me shkronja cirilike (i ndrequr gjuhësisht), është ky: “*Të gjitha fiseve në Shqipni, or vllazni*”.

“*Gjithkush din, pa emën të Madhnisë së Zotit, kurgja në fytyrë të tokës nuk mundet me u bo. Na me emër, e me ndihmln e Allahut jemi nisur, e po vimë me kuvet tona te ju. Po vimë në dhe tuej, e tonin që na kanë zaptue os-  
mallinjt, që pesëqind e përmbi vjet, ama nuk po vimë zullum me iu bo, por po vimë zullumin me ua heqë.*

*Ju vetë po shihni, or vllazni, çka po u bajnë osmallinjt (masuz Xhonturqit). Gjo pa iu bo nuk lanë. Me ushtri e me topa u rrëzuan shtëpiat, u çarten katundet, ua shkelën robt, mbushën hapsanët me djemt tuaj, edhe kurrkund, as në prag të shtëpisë nuk u lanë hahat. Zullumi, qi shqiptari shqiptarit nuk ia duron, edhe mbi tana ato po ua marrin djemt e po ua çojnë në Anadoll, e në Arabistan, me derdhë gjak për ta.*

*Për at, e për shumë aso nevojas, jeni konë çue në kombë, e keni luftue trimnisht me ta, ani çka u ba? Mbasi me to-  
po e me pushë nuk mujten me ju ndalë, ju doli me mashtrim, t'u ju thonë me fjalë të mira çka po lypni, por për njëmend jo.*

*U kanë ndalë prej lufte or vllazni, por me emër e me kyvet të Zotit, na po ia nisim luftës prej atyhit, ku e keni lanë ju, edhe me emër të Zotit tona nevojat qi keni luftue aq trimisht për ta, do t'u plotësohen kur vimë na te ju.*

*Na po vimë te ju or vllazni, tue ju pru selametin e drejtën, e tue bo: me konë trinjia e moçem, njerëzia moçme, erzi i moçëm e ihtibari moçëm ne vend të veet, si o konë ndër ditë të moçme edhe për kto mukades sendet tuja, kemi gjak me derdhë, sikur për tonat.*

*Mos u boni shybe, or vllazni, se qe besa e Zotit, s'po vimë me sherr, por po vimë me bes malsis, e me hajr. Mos bani shybe se bohet ndryshe, por keni me pas fenë e vet, adetet e veta e sundimin ndërmjetveti, si të doni. E si ka pas Shqipnia prej Leke e të këndej.*

*Besn'e Zotit po ua lamë peng, qi kemi me lon në harresë tona të kqija, çka jonë konë deri tash, edhe s'kemi me lonë me u ba ndryshe, por gjithë kunjja do t'i bohet: feja fe, erzi erz, e malli mall, edhe kurrkush kunjna zullum mos me bo. Pushkën kemi me qitë në ata, qi qesin në ne, edhe na lasht Zoti, shkrum kemi me e bo qat shpi, e katund, qi na kthen pushkën, e qato qi na pret vllaznisht, kemi me e përqaftë vllaznisht, sikur vllahun vllanë, se po bimë me një dorë: Bes'en e Zotit, drejtën e njerëzinë, e me qetrin po bajm arm e zjarrm.*

*Qeso besë po u japim, edhe qeqшту me shëndet po çojmë se zemani asht ardhur, or vllazni, me u coptue ylqeqja osmanllive, e na me ju, sikur ju me ne, me jetue vllahisht me saje Krajlit Petrit qi na ka bo emr, qet me shëndet, e qet me besë, me u çue.*

*Or vllazni, ne emnin e Krajlit qe e bomë, e këtë me shëndet, bashkë me bes'n e Zotit, po u çojmë. Borxhin e vet para Perendisë, edhe para gjindve e lamë. Për besen tonë, madhminë e Zotit e kemi ispatl, e kush bohet se bep me u derdh gjaku, Zoti me madhminë e vet ja sudoftë.*

*U pjekshim për ajet ir vllazni!*

*Tersherinievel 1328.*

*N. Podujev*

*Komandari i ushtrisë të srpit,  
Bozhidar Janko*



përballë katastrofës që kërcënonte Perandorinë Osmane. Por, si mund të bëhej kjo kur ushtritë ballkanike luftën kundër Perandorisë Osmane e kishin filluar me moton “*e luftës çlirimtare kundër sundimit shekullor osman*”, ndërsa për qëllim kishin pushtimin e tokave shqiptare dhe pengimin e bërjes së Shqipërisë shtet?

Këtë më së miri do ta tregojë sjellja e Serbisë dhe e Malit të Zi, të cilat në tokat shqiptare do të hynë me “*thirrje vëllazërore*” për “*luftë të përbashkët çlirimtare*”, ndërkohë që do të shfaqen në rolin e një pushtuesi të ri, që për qëllim kishte shkatërrimin e plotë të qenies shqiptare.<sup>1517</sup>

Në të vërtetë, këtu dhe te kjo parullë, Shqiptarët do ta shohin fare mirë dallimin midis luftës për barazi (autonomia shqiptare) me mjete legjitime përbrenda Perandorisë Osmane, që kishte qenë moto e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare që nga “Lidhja Shqiptare e Prizrenit” e tutje, dhe “luftës çlirimtare” (si model sllavo-ortodoks), kundër Perandorisë Osmane, të shfaqur që nga kriza e kurdisur maqedonase e këndeje, që së pari dhe më së rëndi i qëllonte ata.

Megjithatë, Shqiptarët nuk do të mund të heqin dilemën me të cilën tashmë ballafaqoheshin rreth mbrojtjes së Perandorisë Osmane për të mbrojtur interesat e tyre ekzistenciale (që të mos bëheshin pre e fqinjëve, të cilët ndodheshin në luftë me Perandorinë Osmane) dhe përgjegjësisë që të mos rrokulliseshin në greminë me të?

Qysh në fillim të tetorit gazeta “*Liri e Shqipërisë*”, që përfaqësonte opinionin e kolonisë shqiptare të Sofjes, duke parashikuar ngjarjet, u drejtohej Shqiptarëve me thirrjen: “*të marrim armët dhe të mbrojmë kufijtë e mëmëdheut tonë, duke kërkuar autonominë e Shqipërisë*”. Kjo gazetë u drejtohej Shqiptarëve t’u përmbaheshin udhëzimeve të Sami Frashërit në veprën “*Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhetë?*” t’i jepnin një goditje të fortë Turqisë për të mos u rrokullisur me të në greminë.<sup>1518</sup>

Po në këtë kohë, përfaqësuesit i Austro-Hungarisë në Rumani i telegrafonte Vjenës se Shqiptarët në Turqi kishin vendosur të shërbenin në front: ata të vilajetit të Janinës kundër Greqisë, ata të Shkodrës kundër Malit të Zi, ata të Kosovës dhe të sanxhakut kundër Serbisë dhe ata të Manastirit kundër Bullgarisë.<sup>1519</sup>

Shikuar jashtë kontekstit të realiteteve të njëmendta shoqërore dhe politike, dilte se Shqiptarët në frontin ballkanik midis Aleancës së Vendeve Ballkanike merrnin anën e Perandorisë Osmane, gjë që ata, me rastin e humbjes së luftës, i ballafaqonte me pasojat, siç do të ndodhë në të vërtetë.

<sup>1517</sup> Shih Ratkovic, B: “*Srbija i Crna Gora u Balkanskim ratovima 1912-1913*”, Beograd 1972.

<sup>1518</sup> “*Historia e popullit shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 504.

<sup>1519</sup> Czerni drejtuar ministrisë së punëve të jashtme, telegram në kod nr. 1263, 6 tetor 1912, HHStA, PA XIV/41, Albanien, XXXIV.

Por, shqiptaro-amerikanët, të cilët në prill atij viti kishin formuar shoqatën panshqiptare “*Vatra*”, kishin mendimin se Shqiptarët duhet të luftonin në anën e Perandorisë Osmane, nga bindja se ajo nuk kishte për t’u thyer nga aleatët ballkanikë. Ata ishin të prirë të besonin se simpatia e mugët që Austria kishte për Shqipërinë do të kthehej në një aksion konkret politik të dobishëm për të. Për hir të Shqipërisë, ata propozonin që t’i jepnin fjalën dhe çdo ndihmë Perandorisë Osmane.

Këtë mendim veçmas do ta sforcojnë Faik Konica dhe Fan S. Noli.<sup>1520</sup>

Prifti, Naum Care, në mbledhjen që e organizoi “*Vatra*” për këtë çështje thoshte:

*“Turqia, duke ua pranuar kryengritësve Shqiptarë kërkesat e tyre, e bëri të mundshme ekzistencën kombëtare të Shqipërisë. Ky zhvillim që një goditje vdekjeprurëse për cënnonjë të shteteve ballkanike. Prandaj, duket sheshi që interesi ynë qëndron në një bashkëpunim të përzemërt me ushtrinë turke kundër armiqve të Perandorisë, që janë kryesisht armiqtë e Shqipërisë”*.<sup>1521</sup>

Pa filluar lufta, Perandoria Osmane mobilizoi Shqiptarët në ushtrinë e saj. Porosia e drejtuesve të kryengritjes drejtuar luftëtarëve dhe popullit shqiptar nga Shkupi, pasi që të ishin pranuar kërkesat e tyre, ishte se duhej mbrojtur atdheu nga kërcënimet që ishin në prag, por kjo ishte vetëm një thirrje patriotike që nuk çonte peshë jashtë një organizimi të caktuar. Në mungesë të një organizimi shqiptar së paku të një niveli që ishte parë gjatë kryengritjes së asaj vere, kjo nënkuptonte bashkëpunimin me ushtrinë osmane, e cila pat premtuar masa të veçanta për përfshirjen e Shqiptarëve në mbrojtje të vendit, siç ishte dorëzimi i armëve dhe mundësia e organizimit të njësisive të posaçme rezerviste, të cilat do të drejtoheshin nga instruktorë ushtarakë, të stërvitur nga ekspertët gjermanë të përgatitur enkas për sfida të tilla.<sup>1522</sup>

Por as njëra e as tjetra nuk do të ndodhë. Sepse, 50 mijë armë që thuhej se ishin nisur në Kosovë dhe u qenë dorëzuar disa nga liderëve vendorë (Isa Boletini, Idriz Seferit dhe të tjerë), për arsye të panjohura, nuk do të shpërndahen.<sup>1523</sup>

Megjithatë, në Shqipëri me shpërthimin e luftës, nismën për një veprim politik, që ta nxirrte vendin nga gjendja e vështirë, e morën shoqëritë atdhetare: Komiteti “*Shpëtimi*” dhe “*Shoqëria e Zezë për Shpëtim*” e krijuar në Shkup. Përfaqësuesit e tyre Sali Gjuka, Nexhip Draga, Bedri Pejani, Mit’hat Frashëri dhe të tjerë, organizuan në Shkup, më 14 tetor një mbledhje, pasi që të kenë marrë miratimin e

---

<sup>1520</sup> “*The Albanian Struggle in the Old World and New*”, Boston, 1939, faqe 48-49 dhe Skëndi, Stavri: “*Zgjimi kombëtar shqiptar*”, Tiranë, 2000, faqe 408.

<sup>1521</sup> Po aty, faqe 50.

<sup>1522</sup> “*Historia e popullit shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 505.

<sup>1523</sup> Abdyli, Tahir: “*Hasan Prishtina*”, Prishtinë, 2003, faqe 170-173.

Hasan Prishtinës, i cili bashkë me disa nga udhëheqësit e kryengritjes së gushtit, kishte shkuar në front për mbrojtjen e tokave shqiptare.<sup>1524</sup>

Mbledhja doli me një qëndrim me të cilën u bëhej e ditur Fuqive të Mëdha:

*“Shqipnia i ka i kapë armët jo me forcue dominacionin e Turqisë në Ballkan, por me i dalë zot tanësis tokësore e lirisë së Shqipnis. Pra, qysh prej sodit po ju deklarojmë se sido që të jet fati i armëve, Shqiptarët nuk kan me pranue prej katër vilajete veçse një formë politike e një sundim”.*<sup>1525</sup>

Në të vërtetë, proklamata e Shkupit, e cila më 16 tetor iu dorëzua përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha në Shkup, paraqet thelbin e një manifesti politik, ku pasqyrohet qëndrimi shqiptar pse luftohej, por po ashtu dilnin në pah edhe qëndrimet rreth ardhmërisë së tyre në rrethanat e pasluftës:

*“Për me i dalë zot tanësis tokësore e lirisë së Shqipnis”, dhe*

*“Për të bërë të ditur se “pa marrë parasysh si do të jetë fati i armëve, Shqiptarët nuk kan me pranue prej katër vilajete veçse një formë politike dhe një sundim”.*

Si do të shihet këto dy çështje sqarojnë fare mirë esencën e Luftës Ballkanike dhe absurditetet e saj, që dilnin në pah më së miri tek çështja shqiptare me atë se ajo nuk do të jetë çlirimtare, siç proklamohej, por pushtuese, sepse ushtritë e Aleancës Ballkanike, sipas marrëveshjeve paraprake, secila do të nxitojë që të pushtojë pjesët e tokave shqiptare dhe kështu të krijojë fakte të kryera me dhunë me anën e të cilave duhej të pengohej shpallja, po edhe pranimi i Shqipërisë së pavarur, që do të ishte e pashmangshme në ato rrethana.

Faktet e kryera me dhunë, pra pushtimi i tokave shqiptare nga ushtritë malaziasse, serbe, greke dhe bullgare ndodhën brenda një kohe të shkurtër, pasi që ta kenë shpartalluar ushtrinë osmane në të gjitha frontet. Edhe pse, shikuar realisht, kjo nuk pritej të ndodhte, kur kihej parasysh aftësia e ushtrisë osmane dhe epërsia me forcat që kishte në pjesën europiane dhe armatimin shumë të mirë që posedonte.<sup>1526</sup>

---

<sup>1524</sup> “Historia e Popullit Shqiptar”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 505; Abdyli, Tahir: “Hasan Prishtina”, Prishtinë, 2003, faqe 162.

<sup>1525</sup> Gazeta “Populli”, nr 43, cituar sipas Abdyli, Tahir: “Hasan Prishtina”, Prishtinë, 2003, faqe 162.

<sup>1526</sup> Forcat ushtarake të Perandorisë Osmane në pjesën europiane në raport me ato të aleatëve ballkanikë (Serbisë, Malit të Zi, Greqisë dhe Bullgarisë) ishin për tridhjetë mijë më shumë. Forcat osmane numëronin 256 mijë, ndërsa ato të përbashkëta të katër vendeve rreth 220 mijë. Ushtria osmane ishte e përqendruar në tri Armata të mëdha: atë të Edrenës (me rreth 120 mijë ushtarë), të Manastirit (me 80 mijë ushtarë) dhe të Janinës 60 mijë ushtarë). Krahas tyre, ishin edhe rezervistët, kryesisht Shqiptarë që kalonin 60 mijë veta. Edhe sa u përket pajisjeve ushtarake (armatimi i lehtë dhe i rëndë), ushtria osmane ishte dukshëm në gjendje më të mirë se ato të vendeve ballkanike. Dy divizionet e altilierisë osmane kishin mbi 1000 topa të kalibrit të mesëm dhe të largët, kryesisht prodhim gjerman, që sapo ishin stacionuar në pjesën europiane dhe udhëhiqeshin nga instruktorë ushtarakë gjermanë.

Trupat bullgare, pasi thyen qëndresën e forcave osmane, të përqendruara në Trakinë Lindore, iu drejtuan Adrianopojës. Forcat e Malit të Zi, të ndara në tri kolona, sulmuan dy në drejtim të Shkodrës dhe njëra në drejtim të Pejës. Brenda tri javësh ato pushtuan Pejën dhe iu drejtuan Shkodrës.<sup>1527</sup>

Më 15 tetor filloi mësymja e trupave serbe në rajonin e Vranjës, ndërsa më 18 tetor u hodh në sulm gjithë ushtria prej 120 mijë vetash, në drejtimin Nish-Manastir-Elbasan, Nish-Manastir-Selanik dhe Kurshumli-Prizren-Durrës. Forca të tjera sulmuan nga veriu, në drejtim Rashkë-Mitrovicë-Pejë dhe Javor-Prepolje.<sup>1528</sup>

Forcat osmane, pasi që u ndanë në dysh: njëra në pjesën lindore tutje Adrianopojës dhe tjetra në drejtim të Shkodrës dhe Janinës, thuajse pa luftë, ua lëshuangjithë hapësirën ushtrive pushtuese serbe, malaziasë dhe greke drejt hapësirës shqip-tare. Në vijat e frontit lanë njësitë rezerve (kryesisht Shqiptarë) dhe vullnetarët Shqiptarë. Këta të fundit hyrën në luftë në saje të organizimit të bërë nga krerët e Kosovës, në radhë të parë Hasan Prishtinës, Nexhip Dragës, Bajram Currit, Isa Boletinit, Idriz Seferit dhe të tjerëve, duke u përqendruar në pjesën e Podujevës, atë të Kumanovës dhe të Shkupit. Fronti i lindor kishte për qëllim t'u ndalej turri usht-rive pushtuese (serbe dhe bullgare), duke shpresuar se Fuqitë e Mëdha do të mund të ndërprisnin depërtimin e ushtrive të tyre në trojet shqiptare.

Por, si do të shihet, Fuqitë e Mëdha nuk do ta bëjnë këtë. Përkundrazi, filluan të merren me kohën pas osmane. Kështu që, e gjithë rezistenca shqiptare, ndonëse heroike, nuk zgjati më shumë se dyjavë. Ndonëse do t'u shkaktojnë humbje të ndjeshme forcave serbe në frontin e Podujevës dhe atë të Kumanovës, kjo nuk do të mjaftojë, ngaqë kishin të bënin me armata të organizuara dhe të pajisura mirë me artileri dhe armatime të ndryshme, para së cilës u thyen. Por, ushtritë serbe dhe malaziasë, duke shfrytëzuar faktin që rezistencën shqiptare në mbrojtje të trojeve të veta ta paraqesin si “*luftë të Shqiptarëve për të mbrojtur pushtuesin shumë-shekullor osman*”, sapo u futën në tokat e tyre, në përputhje me elaboratet e njohura antishqiptare. filluan qërimin e hesapeve me popullatën e pambrojtur.

Kështu, njësitë e posaçme serbe, kryen krime të rënda kundër popullsisë shqiptare. U masakruan gra, fëmijë dhe pleq. Ndërkohë që artileria e tyre rrafshoi katunde të tëra, duke detyruar që ata që mbijetonin masakrën, të shpërnguleshin. Vlerësohet se gjatë operacioneve të luftës pushtuese në Kosovë ushtria serbe masakroi mbi 50 mijë Shqiptarë, ajo malaziasë rreth 20 mijë veta. Ndërkohë që mbi 150

---

<sup>1527</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 505.

<sup>1528</sup> Po aty, faqe 505.

mijë të tjerë si refugjatë kaluan në Shqipëri ose morën rrugën për në Turqi. Ishte kjo njëra ndër masakrat e përmasave të gjenocidit ndaj popullsisë shqiptare, që nuk mbeti e pa parë edhe nga jashtë dhe pa u gjykuar edhe pse pa pasojë.<sup>1529</sup>

Krahas masakrimeve të shumta, ushtria pushtuese serbe, në muajin nëntor, arrestoi edhe disa nga krerët e lëvizjes shqiptare, të angazhuar për t'i mbrojtur trojet shqiptare nga pushtimet. Ndër ta ishte Hasan Prishtina, Nexhip Draga, Idriz Seferi, Sait Hoxha, Kasum Seferi dhe shumë të tjerë. Meqë nuk pranuan të nënshkruanin deklaratat e besnikërisë ndaj Serbisë, u hodhën në burgjet e Beogradit, ku u mbajtën deri më 16 maj 1913.<sup>1530</sup>

Për qëllime propaganduese dhe për ta shtuar “moralin patriotik serb”, qeveria serbe, dërgoi në Beograd edhe disa mijëra rob luftime shqiptarë nga fronti i Kumanovës, që të parakalojnë në “defiletë fitimtare” në fillim të dhjetorit të vitit 1912 kur ushtria serbe deklaroi “*çlirimin e tokave serbe të pushtuara nga Perandoria Osmane*”.

Princi Aleksandar Karagjorgjeviq me këtë rast, para turmës së entuziazmuar serbe, deklaroi:

*”Unë dëshiroj vetëm që këtu të vijnë disa mijëra europianë me përgjegjësi e të shohin Shqiptarët, të cilët ne i kemi zënë robër, dhe ata të binden se këta njerëz mezi mund të quhen njerëz dhe të përfitojnë bindjen se Ballkani patjetër duhet të spastrohet nga këto egërsira.”*<sup>1531</sup>

Fjalët e Karagjorgjeviqit, shpjegojnë gjithë strategjinë e Luftërave Ballkanike dhe qëllimet që ndoqën Serbia, Mali i Zi, Greqia dhe Bullgaria ndaj Shqiptarëve dhe çështjes së tyre, duke u munduar që me mjetet e luftës ta hiqnin nga trajtimi i pashmangshëm politik.

Pushtimi i territoreve shqiptare, ndarja e tyre në katër pjesë, ushtrimi i gjenocidit ndaj popullatës shqiptare, duhej të parandalonte me çdo kusht faktorin shqiptar që të merrte rolin e “*digës kundër pansllavizmit*”, që për herë të parë ishte përmendur nga përfaqësuesi anglez në Kongresin e Berlinit në vitin 1878, prej nga ishte kthyer në koniunkturë politike të sferës së interesit të Perëndimit.<sup>1532</sup>

Disfata e ushtrisë osmane dhe pushtimet serbe, malaziasë, greke dhe bullgare ndaj pjesës së mbetur të Turqisë europiane (kryesisht të tokave shqiptare) sollën lëvizje të ndjeshme midis Fuqive të Mëdha, në radhë të parë te Austro-Hungaria.

---

<sup>1529</sup> Rreth masakrave të ushtrisë serbe gjatë pushtimit të Kosovës më gjerësisht shih edhe autorët serbë: Tucoviq, Dimitirje: “*Srbija i Arbania*”, Beograd, 1945, Leo Frojndlihi “*Golgota shqiptare*”, 1913; Abdyli, Tahir: “*Hasan Prishtina*”, Prishtinë, 2003.

<sup>1530</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 508.

<sup>1531</sup> Abdyli, Tahir: “*Hasan Prishtina*”, Prishtinë, 2003, faqe 171.

<sup>1532</sup> Më gjerësisht shih: Buxhovi, Jusuf: “*Kongresi i Berlinit 1878*”, Prishtinë, 2008.

Vjena tashmë e kishte të qartë se faktet e kryera me dhunë nga ushtritë aleate ballkanike, në të vërtetë shfaqeshin si fakte me të cilat jo vetëm që rënohej baraspesha politike në Ballkan, por ajo ndryshonte sferat e interesit në këtë pjesë në dobi të Rusisë, gjë që ishte e papranueshme për të, por edhe për vendet tjera të Boshnit Trepalësh, e madje edhe për Anglinë.

Kështu, qysh gjatë muajit tetor, në Vjenë u mbajtën disa konferenca ministrore, në të cilat u diskutuan çështjet që u përkisnin interesave austriake. Njëra nga ato (midis 25 dhe 30 tetorit) u mor gjerë e gjatë me ndryshimet territoriale në Shqipëri. Sa për fatin e Shqipërisë, konferenca e shprehu opinionin që ishte në interesat vitale të Monarkisë ta ruante atë vend pa marrë parasysh rezultatet e luftës.<sup>1533</sup>

Meqë ishte imperativ që Monarkia të ndalonte një fuqi të madhe, ose edhe një të vogël, të vinte këmbë në bregdetin lindor të Adriatikut, sidomos në detin Jon, që menduar se duhej krijuar një Shqipëri autonome, ose në rastin e rënies së sovranitetit osman, një Shqipëri e pavarur.<sup>1534</sup>

Edhe sa i përket territorit të këtij entiteti, ishte në interes të qëndrueshmërisë dhe fuqisë së tij, që të përfshiheshin sa të ishte e mundur më shumë troje osmane të banuara me Shqiptarë. Me këtë rast u soll qëndrimi se në rrethanat e reja – mendohej të ato të pushtimeve të fqinjëve në Shqipëri – ajo të jetë e zonja për një jetë të pavarur.<sup>1535</sup>

Kjo pikë e programit, iu komunikua Gjermanisë më 30 tetor dhe Italisë më 3 nëntor.<sup>1536</sup>

Kur ishte bërë e qartë se *status quo-ja* nuk mund të ruhej më gjatë, Berhtoldi i propozoi Rusisë më 17 nëntor një shkëmbim mendimesh mbi caktimin e kufijve dhe organizmin e brendshëm të Shqipërisë. Vetëm krijimi i një Shqipërie të pavarur dhe siguria e territorit të saj mbeti qëllim i shprehur i politikës ballkanike të Austro-Hungarisë.<sup>1537</sup>

Më 21 nëntor, Avarno ia komunikoi zyrtarisht Vjenës se San Giuliano ishte i pajtimit me programin për Shqipërinë, porse përgjigjja e hollësishme nga Roma u dërgua më 24 nëntor.

Se Vjena tashmë shfaqej si adresë e vetme dhe më e sigurt e Shqiptarëve në ato rrethana tepër tragjike, këtë do ta tregojë edhe një kërkesë e parisë së pjesës Ti-

---

<sup>1533</sup> Shih “*Österreich-Ungarns Aussenpolitik 1908-1914*”, Vjenë, nr. 4170.

<sup>1534</sup> Po aty.

<sup>1535</sup> Po aty.

<sup>1536</sup> Skëndi, Stavro: “*Zgjimi kombëtar shqiptar*”, Tiranë, 2000, faqe 410.

<sup>1537</sup> Shih diskutimet e Berhtoldit te L. Salvatorelli: “*La Triplice Alleanza, storia diplomatica, 1877-1912*”, Milano, 1939. Faqe 450-452, sipas Skëndi, Stavro: “*Zgjimi kombëtar shqiptar*”, Tiranë, 2000, faqe 410.

ranë-Durrës, më 12 nëntor 1912 kur pasi që pjesa më e madhe e vilajeteve shqiptare qenë pushtuar nga aleatët ballkanikë, do t'i drejtohen perandorit austriak Franc Jozefit II, me kërkesën që Austro-Hungaria t'u vinte në ndihmë Shqiptarëve. Ata i bënë thirrje perandorit të Austro-Hungarisë që të siguronte ruajtjen e integritetit territorial të Shqipërisë dhe t'i jepej kësaj një autonomi e plotë përbrenda shtetit osman.<sup>1538</sup> Nëse Turqia, si pasojë e luftës, do të ishte e zonja të sundonte mbi tokën shqiptare, ata kërkonin që të krijohej një mbretëri shqiptare e ngjashme me atë të popujve ballkanas. Po të ishte e mundur, kjo mbretëri duhej të ishte si Belgjika ose Zvicra për të ruajtur ekuilibrimin në Ballkan. Ata përfundonin duke thënë se shpresat e tyre mbeteshin te Franc Jozefi II.<sup>1539</sup>

Një javë më vonë, thirrje Fuqive të Mëdha, nga Stambolli do t'u drejtojnë edhe personalitetet shqiptare në Stamboll – dhe këta qenë shumë si Toskë, si Gegë, të krishterë e myslimanë. Aty, pos të tjerash, thuhej se Fuqitë e Mëdha duhej të ndërhyenin sa më parë, që të ndalonin katastrofën që po u kërcënohej Shqiptarëve si dhe të zgjidhnin një herë e mirë çështjen shqiptare në përputhje me të drejtën. Në këtë thirrje thuhet se populli Shqiptar, i njohur për përpjekjet e tij për pavarësi si në të kaluarën ashtu edhe në të tashmen, meritonte të respektohej nga Fuqitë e Mëdha. Ata deklaruan se populli shqiptar nuk do të lejonte asnjë ndryshim në *status quo*-në territoriale të pjesës së Turqisë europiane, që do të merrte nëpër këmbë të drejtat e tij. Ata nuk do të lejonin përzierjen e shteteve ballkanike në administrimin e tokave që u përkisnin Shqiptarëve. Ata do të ruanin zakonet e tyre, do të zhvilloheshin sipas koncepteve sociale dhe politike, dhe do të mbeteshin zotë të fatit të tyre.<sup>1540</sup>

Që Shqiptarët të mbeteshin “zotë të fatit”, siç pretendonin intelektualët e Stambollit në deklaratën drejtuar Fuqive të Mëdha, në rrethanat kur ushtritë aleate të Ballkanit tashmë kishin pushtuar Shqipërinë dhe e kishin ndarë në katër pjesë, më së paku dukej se varej nga vullneti i tyre. Më 17 nëntor, pasi që Serbia të kishte pushtuar Kosovën dhe trupat e saj kishin rrethuar edhe Durrësin, ndërsa Malaziasit, Grekët dhe Bullgarët kishin ndarë në katër pjesë tokat shqiptare, Faik Konica, në një mbledhje të “*Vatrës*” në Boston foli gjithë dëshpërim:

*“Turqia u mund dhe Shqipëria është shkelur dhe në rrezik që të copëtohet. Ç’duhet të bëjmë në Shqiptarët nacionalistë për të shpëtuar atdheun tonë?”*

Pyetjes së shtruar do t'i përgjigjet:

---

<sup>1538</sup> Po aty.

<sup>1539</sup> Po aty.

<sup>1540</sup> Shih apelin e Shqiptarëve drejtuar Pallavicinit dhe raportin e tij më 19 nëntor 1912, nga Kostatinopoja, nr.88, HHSa, PA XXI/47, Türki XXXXV/6.

*“Duhet kërkuar ndihmë nga Fuqitë e Mëdha që Shqipëria të mos mbetet pre e fqinjëve grabitqarë”.*<sup>1541</sup>

Përballë këtij realiteti tragjik, Shqiptaro-amerikanët, me anën e telegrameve, do t’u drejtohen perandorëve të Austrisë dhe të Gjermanisë dhe mbretit të Italisë, Papës, Ministrit të Jashtëm të Rusisë dhe Francës si dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës me kërkesën që të parandalohet copëtimi i Shqipërisë.

Megjithatë, telegramet, apelet, letrat dhe protestat nuk mjaftonin. Kërkohej veprim politik dhe diplomatik në shkallën e një përgjegjësie historike që duhej marrë nga liderët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, pikërisht nga ata që në fillim të vitit ishin përcaktuar për kryengritjen shqiptare me të cilën do të rrëzohej regjimi i Xhonturqve në mënyrë që t’i krijoheshin rrethanat jetësimit të autonomisë shqiptare përbrenda Perandorisë Osmane. Por, në ato rrethana tragjike kjo thujse ishte e pamundur, ngaqë Perandoria Osmane kishte humbur luftën me vendet ballkanike, që për pasojë kishte pasur pushtimin e tokave shqiptare dhe copëtimin e tyre në katër pjesë, pikërisht siç kishin paraparë Serbia, Mali i Zi, Greqia dhe Bullgaria në traktatet e tyre të lidhura kohë më parë. Ndërsa udhëheqësit kryesorë të kryengritjes së Kosovës, që kishte sjellë deri të rrëzimi i qeverisë xhonturke dhe shpërndarja e parlamentit, (Hasan Prishtina, Nexhip Draga, Idriz Seferi dhe të tjerë), gjatë kohës sa organizonin mbrojtjen e trojeve shqiptare nga pushtimet e fqinjëve, pra ata që kishin luftuar, ishin burgosur nga Serbia dhe ishin dërguar në internim në Beograd.

Kështu që, pushtimet e trojeve shqiptare nga ushtritë serbe, malazeze, greke dhe bullgare, krahas terrorit të paparë ushtarak ndaj popullatës së pambrojtur, kishin pamundësuar çfarëdo veprimtarie politike, që do të lidhej me fatet e Shqipërisë.

Dhe, nëse në Shqipëri nuk mund të bëhej gjë, megjithatë mbetej Stambolli dhe diaspora shqiptare prej nga duhej filluar sa më parë nisma që të dalë zëri i Shqipërisë, çfarëdo qoftë ajo: autonome ose e pavarur.

Kjo barrë do t’i bie Ismail Qemalit, njeriut që edhe deri më atëherë kishte qenë personaliteti i rëndësishëm shqiptar njëherësh politikan dhe diplomat i lartë nga hierarkia osmane, i cili mund të merrej seriozisht nga faktori i jashtëm.

Ismail Qemali ishte ngarkuar me këtë detyrë, me rastin e Marrëveshjes së Takimit në shkurt kur bashkë me Hasan Prishtinën dhe të tjerët kishin ndarë detyrat për organizimin e kryengritjes shqiptare, e cila do të përfundojë me Memorandumin e Katërmbëdhjetë Pikave të Shkupit, hartuar nga Hasan Prishtina dhe pranuar nga qeveria osmane. Me këtë praktikisht i hapeshin dyert autonomisë shqiptare në përbërje

---

<sup>1541</sup> “*The Albanian Struggle in the Old World and New*”, faqe 50, cituar sipas Skëndi, Stavro: “*Zgjimi kombëtar shqiptar*”, Tiranë, 2000, faqe 412.



të Perandorisë Osmane. Meqë Hasan Prishtina thuajse i vetmi kishte kryer detyrat e marra nga Marrëveshja e Taksimit dhe, me të filluar lufta ballkanike, bashkë meshu-micën e krerëve shqiptarë angazhohet në Kosovë për të organizuar mbrojtjen e tokave shqiptare nga pushtuesit serbë e malazias dhe do të arrestohej nga Serbët në vijat e para të frontit bashkë me shumë të tjerë, i mbetej Ismail Qemalit që të vazhdonte punën madhore të Hasan Prishtinës e të patriotëve të tjerë që në bashkëpunim dhe marrëveshje me Fuqitë e Mëdha, me këtë rast me Vjenën si aleat të vetëm të mundshëm, të sigurojë mbrojtjen e Shqipërisë, për çka kishte edhe miratimin e Paktit Trepalësh.

Vetë Ismail Qemali pranon se *“kur aleatët ballkanas i shpallën luftë Turqisë, dhe armatat bullgare kishin zaptuar Kirk-Kilisen, ndërsa Serbët kishin zaptuar Shkupin, unë e kuptova se për ne Shqiptarët kishte ardhur koha që të merrnim masa të forta për shpëtimin tonë”*.<sup>1542</sup>

Në këto rrethana, kur fati i Shqipërisë varej nga Fuqitë e Mëdha, Ismail Qemalit nuk i mbetej tjetër pos t’i drejtohej Vjenës për ndihmën përfundimtare, mbështetëses së vetme, me shpresën se aty do të merrte përkrahjen për mënyrën si duhej sjellë që të shpëtohej Shqipëria dhe për vendimin që duhej marrë. Para se të nisej për në Rumuni, i shoqëruar nga Luigj Gurakuqi, një gazete italiane i deklaronte se *“nuk shihet ndonjë zgjidhje tjetër të problemit shqiptar përveçse një ndërhyrje austriake”*.<sup>1543</sup>

Me këtë rast mendohej nga ndërhyrja politike e deri tek ajo ushtarake.

Në Bukuresht, Ismail Qemali, duhej të merrte përkrahje nga kolonia më e fuqishme shqiptare rreth hapave vendimtarë, e cila gjatë gjithë kohës kishte qenë e rëndësishme për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare.

Më 5 nëntor, në mbledhjen me rrethin e gjerë të patriotëve dhe të veprimtarëve shqiptarë, u vendos:

- të krijohet një komitet drejtues që do të marrë përsipër qeverisjen e vendit;
- të formohet një komision që do të shkojë në Europë për të mbrojtur para qeverive të Fuqive të Mëdha *“të drejtat kombëtare të tokës së popullit shqiptar”*;
- të themelohet një komitet në Bukuresht që do të bashkujdisë veprimtarinë e komiteteve brenda dhe jashtë Shqipërisë me qëllim që të ndihmonte atdheun në mënyrë më efikase.<sup>1544</sup>

Mbledhja e Bukureshtit nuk mund të vendoste nëse Shqipëria do të bëhej autonome apo e pavarur, mbasi kjo varej nga zhvillimet e kohës dhe nga qëndrimet e Fuqive të Mëdha.

---

<sup>1542</sup> Vlora, Qemali Ismail: *“Kujtime”*, Tiranë, 1997, faqe 369.

<sup>1543</sup> Skëndi, Stavro: *“Zgjidhje kombëtare shqiptare”*, Tiranë, 2000, faqe 412.

<sup>1544</sup> Po aty, faqe 413.

Pas kësaj, Ismail Qemali në Bukuresht u takua me të dërguarin e Austro-Hungarisë në Rumuni, princin K. E. Fyrstenberg për t'ia paraqitur qëndrimet e takimit të Bukureshtit, prej nga kishte dalë kërkesa e përbashkët që Vjena të marrë përsipër rolin e mbrojtësit të Shqiptarëve.

Pasi që i dërguari austro-hungarez njoftoi qeverinë e tij me kërkesat e shqiptarëve si dhe pritjet që ata kishin nga Austro-Hungaria, Ismail Qemalit iu bë me dije se Vjena e priste për të biseduar rreth hapave të mëtutjeshëm.<sup>1545</sup>

Rrugën për në Vjenë Ismail Qemali e mori me tren, ku arriti pas një udhëtimi 24 orësh. Më Më 12 nëntor, Ismail Qemali u prit në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Monarkisë nga disa zyrtarë të lartë. Në këtë takim Ismail Qemali foli vetëm për mundësinë e organizimi të një Shqipërie autonome.<sup>1546</sup>

Ky ishte një qëndrim diplomatik dhe politik njëherësh, i cili lidhej me pozicionin e Fuqive të Mëdha, të cilat kishin deklaruar se për fatin e pjesës europiane të Perandorisë Osmane, pra edhe të Shqipërisë, pa marrë parasysh rezultatet e luftës, do të vendosej në tavolinën e gjelbër, e cila do të organizohej së shpejti.

Me këtë rast Ismail Qemali hodhi idenë se duhej thirrur një asamble të personaliteteve shqiptare prej nga pastaj, me qëndrimet e marra, Fuqive të Mëdha t'u adresohet një memorandum ku do të përfshiheshin kërkesat e Shqiptarëve. Ismail Qemali shtroi nevojën që qeveria osmane të urdhërojë autoritetet ushtarake dhe civile në Shqipëri të bashkëpunonin me udhëheqësit e Lëvizjes Kombëtare drejt bartjes së pushtetit autonom tek Shqiptarët dhe me këtë të rumbullakohej marrëveshja e lidhur me Shqiptarët në Shkup në gusht në përputhje me Memorandumin e Katërbëdhjetë Pikave të Hasan Prishtinës.<sup>1547</sup>

Gjatë këtij takimi, Ismail Qemali edhe më tutje sillej në përputhje me frymën e marrëveshjeve të Shqiptarëve me Perandorinë Osmane, duke u mbështetur te Memorandumi i Katërbëdhjetë Pikave, të hartuara nga Hasan Prishtina, i nënshkruar në Shkup. Kjo len për të kuptuar për një manovrim politik dhe diplomatik më se të domosdoshëm ndaj Fuqive të Mëdha për ta shpëtuar vendin nga copëtimi i njëmend që i kërcënohej në rrethanat kur Perandoria Osmane kishte humbur luftën në pjesën europiane dhe mbetej që ato ta thonë fjalën kryesore për fatin e saj të mëtutjeshëm. Por qëndrimet e tyre doemos duhet t'i referoheshin aktit të fundit të marrëveshjes së Shkupit të arritur midis Shqiptarëve dhe Qeverisë Osmane, i cili, njëherësh ishte në përputhje edhe me qëndrimin e deriatëhershme të Fuqive të Më-dha, se do të

---

<sup>1545</sup> Vlorë, Eqrem bej: "Kujtime", vëllimi i parë, Tiranë, 2001, faqe 314.

<sup>1546</sup> Vlorë, Qemal Ismail: "Kujtime", Tiranë, 1997, faqe 370.

<sup>1547</sup> Po aty.

respektohen marrëveshjet e Perandorisë Osmane me popujt e pjesës europiane rreth së ardhmes së tyre. E tillë ishte ajo e Shkupit, që duhej përkrahur.

Zyrtarët e lartë të Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë Ismail Qemalit nuk do t'i thonë tjetër pos që do t'ia përsërisin ato që ato ditë kishte botuar shtypi gjysmëzyrtar i Monarkisë, ku simpatia austriake për Shqiptarët dhe zhvillimet e tyre që e thellë dhe se dëshira e tyre ishte që Austria ta përkrahte integritetin kombëtar të atdheut të tyre me qëllim që të sigurohej paqja në Gadishullin Ballkanik. Ata nuk mund të diskutonin çështjet specifike gjë që ishte ende e parakohshme, për shkak të gjendjes së luftës.<sup>1548</sup>

Përkrahjen përfundimtare për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë Ismail Qemali e mori nga Berhtoldi në Budapest më 17 nëntor. Në *"Kujtimet"* e tij Ismail Qemali thotë që *"Berhtoldi i miratoi pikëpamjet e tij për çështjen kombëtare shqiptare"* dhe prej andejmi po atë ditë ai u telegrafoi miqve në Durrës për thirrjen e delegatëve në atë qytet ose në Vlorë. Ai siguronte ata *"se pozita e Shqipërisë që e sigurt"*.<sup>1549</sup>

Në të vërtetë, kur Ismail Qemali thoshte se *"pozita e Shqipërisë që e sigurt"*, ka të bëjë pikërisht me atë që do t'i thuhej preraz gjatë takimit me Berhtoldin: *"se nuk duhej menduar më për autonominë e Shqipërisë, por për një shtet të pavarur, që duhej shpallur brenda pak ditësh, në mënyrë që Shqipëria në mbledhjen e ardhshme ndërkombëtare të shfaqej si e tillë"*.<sup>1550</sup>

Fjala, pra ishte për një qëndrim të prerë, që tashmë Vjena zyrtare e kishte kovertuar dhe pritej që ta hapte në çastet e duhura.

Se Vjena tashmë ishte përcaktuar për variantin e shpalljes së shtetit të pavarur shqiptar, si opsion të vetëm të mundshëm në ato rrethana edhe në përputhje me interesat austro-hungareze që të parandaloheshin zgjerimi i Serbisë deri në Adriatik, këtë më së miri e shpjegojnë edhe masat që mori Monarkia që Ismail Qemali ta shpallë pavarësinë brenda dhjetë ditësh, në mënyrë që Konferenca e Ambasadorëve, e cila planifikoheshin të mbahej në Londër, ta gjente atë si fakt të kryer.

Ato masa do të jenë të natyrës diplomatike, politike dhe të sigurisë madje. Meqë duhej gjendur një pëllëmbë Shqipëri e pa pushtuar nga Serbia, Mali i Zi, Greqia apo Bullgaria, ku Shqiptarët do ta legjitimonin këtë akt. Kështu që, krahas marrjes së masave që Ismail Qemali dhe përcjellësit e tij të udhëtojnë në Shqipëri nga Triestja – kur atij do t'i sigurohet anija e përcjellë nga fregata e marinës luftarake, e cila do ta

---

<sup>1548</sup> Raporti ditor nr. 4398 rreth vizitës së Ismail Qemalit më 12 nëntor në Ministrinë e Jashtme në Vjenë, botuar në *"Österreich-Ungarns Aussenpolitik 1908 -1914"*, Vjenë

<sup>1549</sup> Skëndi, Stavri: *"Zgjidhjet Kombëtare Shqiptare"*, Tiranë, 2000, faqe 414.

<sup>1550</sup> Po aty.

zbresë në Durrës – Berhtoldi, po atë ditë, kishte telegrafuar zëvendës konsullit të tij në Durrës, Ludwig von Rudnay të mirëpriste Ismail Qemalin dhe shokët e tij dhe të ishte i gatshëm t’i ndihmonte nëse do t’i dilnin vështirësi.

Diplomatit austriak iu dhanë udhëzime që të mos prekte formën e qeverisë, po vetëm të kufizohej së thëni “*që austriakët do të përkrahin pavarësinë dhe integritetin e Shqipërisë*”, një pikëpamje kjo e përkrahur gjithashtu edhe prej Italisë. Ludwig von Rudnay u paralajmërua që të qëndronte larg dallimeve që ekzistonin në mes të politikanëve Shqiptarë dhe të theksonte nevojën për bashkim në mes të tyre. Brenda e telegramit duhej t’u komunikohet përfaqësuesve të Monarkisë në Vlorë dhe Janinë.<sup>1551</sup>

Në Durrës, Ismail Qemali nuk do të ndjehet gjithaq i sigurt për mbajtjen e kuvendit ku do të shpallej pavarësia e Shqipërisë. Ishin dy kërcënime të drejtpërdrejta që njëherësh i vinin: nga ushtria serbe, e cila nuk ishte larg Durrësit dhe kërcënonte çdo çast që atë ta pushtonte. Po ashtu ishte deklarata e peshkopit ortodoks në Durrës, Jakovos, një Grek, “*se ai njihje dhe nderonte vetëm një flamur, atë të Turqisë*”.<sup>1552</sup>

Nuk ka të dhëna se Ismail Qemali të jetë penguar edhe nga forcat osmane, siç është theksuar shpesh. Sepse, kur zbriti në Durrë ende të lirë nga bllokada greke, qyteti ishte nën zotërimin turk, ku prefekt (mytesarif) ishte shqiptari Mahmut Mahir efendiu, ndërsa njeriu më i rëndësishëm në qytet e rrethinë ishte Hamid bej Toptani. Madje edhe ata pak xhandarë të mbetur në qytet ishin të gjithë Shqiptarë.<sup>1553</sup>

Në ato rrethana, kur ushtria osmane po pësonte humbje në të gjitha frontet dhe ajo, sipas udhëzimeve paraprake, preokupim të vetëm kishte grupimin në pikat e tërheqjes (Shkodër dhe Janinë), edhe po të donte, nuk ishte në gjendje që t’u sillte telashe Shqiptarëve për çfarëdo organizimi.

Edhe pse Këshilli Osman i Ministrave ishte i pakënaqur me këtë rrjedhë që morën ngjarjet, ata urdhëruan zyrtarët osmanë në Shqipëri të vazhdonin detyrën e tyre dhe kërkuan ndihmë ushtarake nga Ismail Qemali për ushtrinë osmane, e cila ishte zënë në grackë në Shqipërinë e Jugut.<sup>1554</sup>

Ka shumë indikacione, se disa zyrtarë të lartë osmanë, kishin qenë të kënaqur me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, sepse vetëm ashtu fitonin edhe “një rast” të mirë, që pas humbjes së luftës me fuqitë ballkanike, me futjen në lojë të një Shqi-

---

<sup>1551</sup> Po aty, shih telegramin me shifrën tepër sekret nr. 4498 zëvendës konsullit Rudnay nga Berhtoldi.

<sup>1552</sup> Më gjerësisht shih: Vlorë, Ismail Qemal: “*Kujtime*”, Tiranë, 1979.

<sup>1553</sup> Vlorë, Eqrem bej: “*Kujtime*”, libri i parë, Tiranë, 2001, faqe 314.

<sup>1554</sup> Gawrych, George: “*Gjysmëhëna dhe shqiponja*”, Tiranë, 2007, faqe 306.

përie autonome, qoftë edhe nën një mbikëqyrje ndërkombëtare, të mbronin praninë e tyre në pjesën europiane, gjë që zhvillimet e mëtutjeshme do ta dëshmojnë këtë.<sup>1555</sup>

Pas katër ditësh, Ismail Qemali bashkë me 27 delegatë prej qyteteve të ndryshme të Shqipërisë, duke kaluar nëpër Kavajë dhe Fier (aty do të takohet me delegatët e Kosovës, ndër të cilët Riza beu, Dragajt, Begollët dhe gjeneral Mehmet pashë Drralla), më 26 nëntor 1912 arriti në Vlorë.<sup>1556</sup>

*“Një zjarr i shenjtë patriotizmi kishte pushtuar qytetin tim lindor dhe entuziazmi dhe gëzimi na përshëndetën kudo. Në pak kohë u gjeta i rrethuar nga tetëdhjetë e tre delegatë, myslimanë e të krishterë, të cilët kishin ardhur nga të gjitha anët e Shqipërisë, të zaptuara ose jo nga ushtritë luftuese.”<sup>1557</sup>*

Ismail Qemali thotë se nuk i mbetej kohë për të pritur ardhjen e delegatëve të tjerë. Meqë me përparimin e forcave të aleatëve ballanikë, veçmas të atyre serbë, që po i afroheshin Tiranës, Krujës, Elbasanit dhe Durrësit dhe kërcënonin që së shpejti do të bashkoheshin me forcat greke, gjendja po ndryshonte me shpejtësi.

Më 28 nëntor 1912, në orën 14, u hap në Vlorë Kuvendi Kombëtar. Në mbledhjen e parë të Kuvendit ishin 37 delegatë, të cilët u shtuan gjatë ditëve që pasuan duke arritur në 63 veta, që përfaqësonin të gjitha viset shqiptare. Përveç Ismail Qemalit merrnin pjesë: Luigj Gurakuqi, Sali Gjuka, Bedri Pejani, Rexhep Mitrovica, Vehbi Agolli, Nikollë Kaçori, Jani Minga, Abdi Toptani, Pandeli Cale, Dudë Karbunara, Lef Nosi, Mit’hat Frashëri, Mehmet Deralla, Hasan Hysen Budakova, Ajdin Draga, Sherif Efendi Dibra, Dhimitër Mbroja, Dhimitër Zografi, Shefqet Daiu, Rexhep Ademi, Dhimitër Berati, Kristo Meksi, Xhelal Koprencka, Spiro Ilo, Iliaz Vrioni, Hajredin Cakrani, Shefqet Vërlaci etj. Isa Boletini arriti të nesërmen me 400 luftëtarë.<sup>1558</sup>

Nga udhëheqësit e tjerë kosovarë, për shkak të rrethanave të luftës, nuk mundën të merrnin pjesë Hasan Prishtina, Nexhip Draga, Idriz Seferi, Sait Hoxha etj., që ndodheshin në burgun e Beogradit, si dhe Bajram Curri, i cili, ndonëse u nis për në Kuvend, u pengua nga luftimet rrugës.<sup>1559</sup>

Kuvendi zgjodhi kryetar Ismail Qemalin, i cili foli për të kaluarën e Shqipërisë nën sundimin osman dhe për luftërat e Shqiptarëve për të fituar të drejtat e tyre. Ai vuri në dukje se në rrethanat e krijuara nga Lufta Ballkanike *“e vetmja udhë shpëtimi ishte ndarja e Shqipërisë nga Perandoria Osmane”*.<sup>1560</sup>

<sup>1555</sup> Shih: raporti i Pavallacinit nga Konstantinopoja, 8 dhjetor 1912, nr. 88 HHStA, PA XXI/47, Türkei XXXXV/6.

<sup>1556</sup> Vlora, Eqrem bej: *“Kujtime”*, vëllimi i parë, Tiranë, 2001, faqe 316.

<sup>1557</sup> Po aty.

<sup>1558</sup> *“Historia e Popullit Shqiptar”*, vëllimi i dytë, Tiranë, 2002, faqe 510.

<sup>1559</sup> Po aty, faqe 510.

<sup>1560</sup> Po aty, faqe 511.

Pas atyre që tha Ismail Qemali delegatët nënshkruan dokumentin historik për Pavarësinë e Shqipërisë ku thuhet:

*“Shqipëria me sot të bëhet më vete, e lirë, e mosvarme”.*

## PJESA E KATËRT

# COPËTIMI I SHQIPËRISË



## KAPITULLI I PARË

### KONFERENCA E LONDRËS

#### NJË SHQIPËRI E PËRGJYSMUAR DHE MBETJA E KOSOVËS DHE E MAQEDNISË NËN PUSHTIMIN SERB

Shpallja e pavarësisë Shqipërinë do ta gjejë në një gjendje të katandisur. Shteti shqiptar, që dërgonte mesazhe nga Vlora, jo vetëm që ishte i mbërthyer në disa qindra kilometra katrorë, i mbushur përplot me refugjatë shqiptarë nga viset e pushtuara nga fqinjët si dhe ushtarë osmanë që kishin braktisur fushëbetejat dhe kërkonin shpëtim, por ai ishte i rrethuar nga të gjitha anët me ushtri të huaja pushtuese, të cilat prisnin që ai sa më parë të ngulfatej ende pa filluar frymëmarrjen. Madje, duket thujse absurde, po lajmin e pavarësisë mund ta kenë dëgjuar më shumë veta jashtë (nga gazetat) dhe burimet të tjera sesa vetë Shqiptarët në të. E rëndësishme, megjithatë, ishte se për shpalljen e Shqipërisë shtet dinin ata që këtë nuk e kanë dashur dhe do të bëjnë përpjekje të jashtëzakonshme që ta pengonin dhe ata ishin shumë, siç dinin edhe ato kancelari dhe diplomaci, të cilat e kishin më se të qartë se do t'u binte puna të merreshin me të, së paku në kuptimin që t'i jepej përgjigjja trashëgimisë osmane në Ballkan, e cila doemos se në zgjidhjen e saj përfshinte edhe faktorët e tjerë dhe çështje të shumta nga ato politike, shoqërore e deri te ato të natyrës kulturore dhe shpirtërore të pleksur mes veti gjatë një historie qindravjeçare, e cila nuk ishte vetëm histori pushtimi, por edhe e një ndeshjeje qytetërimesh, që kishte lënë gjurmët e veta të thella, që rrethanat e reja mund t'u jepnin përgjigje politike por assesi jetësore dhe shoqërore, që të kënaqte që të gjithë.

Përgjigjja politike dhe diplomatike që kërkonte trashëgimia osmane në Ballkan nuk ishte vetëm mbyllja e pjesës së fundit në tablonë e mozaikut shtetëror të cilin shfaqja e Shqipërisë e bënte të plotë, por ishte ajo e appetiteve të fqinjëve të Shqiptarëve (Serbisë, Malit të Zi, Greqisë dhe Bullgarisë) që po të plotësoheshin, pikërisht këtë e pamundësonin dhe madje hapnin fesate të tjera, që nuk do të vojnë dhe do të paraqiten si të tilla.



Krahas kësaj, në lojë, po ashtu ishin edhe interesat e Fuqive të Mëdha, të cilat në parim ishin pajtuar me ekzistencën e Shqipërisë, por që ajo nuk mund të përjashtohet nga koniunkturat e sferave të interesit të vendeve të Antantës dhe të Lidhjes Trepalëshe, ku njëra anë favorizonte një Shqipëri etnike (Austro-Hungaria) dhe tjetra parashihte një Shqipëri sa më të dobët (Rusia dhe Franca), e cila vetvetiu do të binte pre e vendeve fqinje dhe me këtë çështja shqiptare pushonte së ekzistuari gjoja nga paaftësia e vetëdëshmimit si shtet.

Kështu dhe me këto preokupime në të vërtetë filloi edhe Konferenca e Ambasadorëve në Londër, më 17 dhjetor të vitit 1912, pak ditë pasi që në Vlorë të jetë shpallur pavarësia e Shqipërisë, ku duhej të vendosej për fatin e saj, pa marrë parasysh se vendi që pushtuar nga të gjitha anët: në Veri nga ushtritë malazise, në Verilindje nga ato serbe dhe në Jug nga Grekët. Përjashtim këtu bënin dy qytete shqiptare: Shkodra në Veri dhe Janina në Jug, ku forcat osmane dhe ato shqiptare të rrethuara bënin rezistencë, por që si do të shihet, mbrojtja e përbashkët do të shfaqet me probleme, të cilat, së paku në Jug, do t'u shkojnë për shtati qëllimeve pushtuese greke ndaj tokave shqiptare.<sup>1561</sup>

Shqipëria edhe si e pushtuar nga fqinjët dhe me përpëlitjet e mbijetimit, tashmë kishte kaluar në skenën politike europiane, pa marrë parasysh tretmanin që do ta ketë në të. Në këto rrethana, megjithatë, Shqiptarët do ta shohin se fati i tyre kryekreje ndodhej në duart e Fuqive të Mëdha, ku duhej luftuar me argumentin se deponimet e tyre të tridhjetë e sa vjetëve të fundit (nga Kongresi i Berlinit e këndej) për ta krijuar autonominë brenda Perandorisë Osmane nuk ishin në shërbim të mbajtjes dhe ruajtjes së saj, por në përputhje me përcaktimet e Fuqive të Mëdha, që koha e *status quo-s* të shfrytëzohet për këtë qëllim në mënyrë që shteti shqiptar të shfaqej si një zhvillim evolutiv, ndaj të cilit duhej sjellë me përgjegjësi, dhe jo të vlerësohet në bazë të logjikës midis “çlirimtarëve” dhe “pushtuesve”, siç kërkohet vendet e Aleancës Ballkanike, me çka Shqiptarët dhe çështja e tyre kategorizoheshin në atë “të humbësve”, pra në anën “e pushtuesve”, që duhej dënuar medoemos.

Qeveria e Vlorës, qysh në komunikatën e parë drejtuar Fuqive të Mëdha, bëri përpjekje ta vërë në pah këtë çështje, por nga druajtja se në ato rrethana edhe do të mund të keqkuptohet, përmendte vetëm rolin e Shqiptarëve dhe të kryengritjeve të tyre të fundit për ta dobësuar Perandorinë Osmane, gjë që kapja për degët në vend se për rrënjët nuk do t'i ndihmojë gjithaq. Përkundrazi, kjo do t'ua

---

<sup>1561</sup> “Historia e Popullit Shqiptar”, III, Tiranë 2007, faqe 19-21.

forcojë “pretekstet” vendeve të Aleancës Ballkanike që të futen në trojet shqiptare me arsyetimet “se luftohej pushtuesi shumëshekullor osman”.

Sidoqoftë, Shqipërinë e shpallën shtet Shqiptarët, pa marrë parasysh se hapësira shqiptare ishte e pushtuar nga të gjitha anët nga ushtritë e Aleancës Ballkanike. Ishte koha që ndaj “alibive”, me të cilat manipulonin fqinjët-pushtues gjoja se ishin aty “pse kishin luftuar pushtuesin shekullor”, Shqiptarët të sillleshin me të drejtën etnike dhe jetësore që edhe ata të jetonin të lirë dhe të barabartë me vendet e tjera europiane. Megjithatë, duhej bërë çmos që faktet e kryera me anën e luftës të mos ktheheshin në fakte politike dhe aq më pak që të përdroreshin si shpërblime, por të veprohej drejt sqarimit që po qe se ato do të vazhdonin të përfilleshin, atëherë “çlirimtarëve” duhej t’u ngarkohej hipoteka e pushtuesve të rinj. Ishte pra rasti, që të veprohej me argumente politike e diplomatike dhe aso të natyrës civilizuese, veçmas kur dihej se edhe midis Fuqive të Mëdha, edhe në ato rrethana tragjike Shqiptarët kishin mbështetës (ndër ta më e zellshmja ishte Austro-Hungaria), e cila kishte qenë fund e krye e përfshirë në procesin e shpalljes së pavarësisë jo vetëm në aspektin politik (duke e dirigjuar atë) por edhe në atë teknik madje (duke ia krijuar rrethanat). Kjo çështje duhej shfrytëzuar sa më shumë që të ishte e mundur.

Ajo që ishte preokupim ekzistencial i Shqiptarëve në ato çaste, njëherësh dhe për fat të mirë, korrespondonte edhe me preokupimin e Fuqive të Mëdha, të cilat u përkujdesen që atë bashkë me çështje të tjera, t’i bartin në tryezën e gjelbër. Në këtë aspekt, çështja shqiptare kishte një rëndësi të veçantë, nga përgjigjja që duhej t’i jepej asaj varej e ardhmja e paqes në rajon dhe më gjerë dhe me të drejtë madje, meqë ajo tashmë ishte kthyer në një nyje nga e cila varej si do të dukej harta politike e Ballkanit, e cila ishte e lidhur ngushtë me sferat e interesit të tyre në këtë hapësirë. Kështu që në këtë hesap, në njërën anë shfaqeshin vendet e Antantës (Franca dhe Anglia me Rusinë) dhe në tjetrën ato të Paktit Trepalësh (Austro-Hungaria, Gjermania dhe Italia), të cilat po ashtu brenda tyre kishin interesa të ndryshme si ndaj çështjes shqiptare si ndaj të tjerave, por që rrethanat e reja tash i kishin nxjerrë në pah dhe ato nuk mund të shtyheshin pa u kryqëzuar mes vetes.

Pikërisht ky kryqëzim shpatash Shqipërinë do ta ndihmojë - që të dalë si shtet i mëvetësishëm, po edhe do ta dëmtojë - që të pranohet e përgjysmuar, nga që ajo do të gjendet midis një trajtimi maksimalisht, pra në përputhje me parimet etnike të shtrirjes së natyrshme dhe të atij minimalist - të rrudhjes sa më të madhe, në mënyrë që të mos jetë në gjendje t’i bëjë ballë sprovës së mbijetimit.

Se lufta për Shqipërinë, në njërën anë, do të kthehej në një luftë për Ballkanin me gjasa për ruajtjen e dukjes europiane dhe në tjetrën anë për Ballkanin me dukje sllavo-ortodokse, kjo ishte e pritshme dhe do të merret vesh qysh kur lufta midis Aleatëve Ballkanikë (Serbisë, Malit të Zi, Bullgarisë dhe Greqisë) kundër Perandorisë Osmane ishte në vllug dhe kahu i saj dihej, meqë Vjena do të jetë ajo që menjëherë ia bëri të ditur Rusisë se qëndronte prapa integritetit të shtetit të ri shqiptar si fakt i pashmangshëm, paçka se lente të hapur modalitetet e pranimit të tij si dhe formën qeverisëse.

Ishte ky një deponim në dobi të shtetit shqiptar ndër më të rëndësishmit, që duhet vlerësuar drejt dhe në përputhje me rrethanat, që do t'i heqë mëdyshjet rreth ekzistencës së tij, të cilat nëpër disa qendra europiane edhe më tutje mbaheshin të hapura dhe lufta e fundit sikur duhej që t'i forconte në dëm të saj.

Po ashtu, edhe Rusia, e cila kishte udhëhequr gjithë skenarin e luftës së vendeve ballkanike sllavo-ortodokse kundër Perandorisë Osmane dhe qëndronte fort prapa kërkesave të tyre për t'i ndarë mes vetes “viset e çliruara”, detyrimisht ishte pajtuar me atë se Shqipëria duhej ta kishte vendin e vet midis shteteve të Ballkanit. Por, atë e parashihte si një principatë të vogël, sa për sy e faqe, që shpejt do të binte në duar të Serbëve dhe të Malazezve, ose do të mbetej vasal i tyre i përhershëm. Deklarimin për të drejtën e shtetit shqiptar në Ballkan, Rusia e kishte nga trysnia, meqë e dinte se Shqipëria, për të cilën “në parim” ishin pajtuar qysh në vitin 1898 gjatë takimit të tyre Franc Jozefi me carin rus me kusht që ajo të krijohej sipas marrëveshjes së dyanshme, pra fifti-fifti,<sup>1562</sup> i duhej Austro-Hungarisë, e i duhej edhe Italisë, që si e tillë, do t'i shkonte përshtati edhe Gjermanisë, pasi që atë e mbronte aleati i saj Austria, e cila ishte në gjendje që për atë të hynte në luftë së pari me Serbinë dhe Malin e Zi e pastaj edhe me Rusinë. Këtë të fundit nuk do ta dëshironte, por nuk e përjashtonte si mundësi, gatishmëri kjo që në ditët dhe muajt e ardhshëm disa herë do të demonstronhet nga ana e Vjenës dhe do të kthehet madje në mjet të vetëm të diplomacisë kur Konferenca e Ambasadorëve do të bllokohet nga arroganca e Malit të Zi dhe Serbisë kundër Shqipërisë.

Rusia, po ashtu e dinte, se edhe vendet e Antantës, Franca dhe Anglia, sado që nuk kishin interesa të veçanta në Shqipëri, edhe ato pajtoheshin me shfaqjen e Shqipërisë dhe vendin e saj në Ballkan, pa marrë parasysh se Franca mbronte

---

<sup>1562</sup> Rreth takimit të Franc Jozefit me Carin Rus si dhe qëndrimin të tyre rreth shtetit të ardhshëm shqiptar në përputhje me një marrëveshje të përbashkët, ku do të respektoheshin interesat e Vjenës dhe të Petërsburgut fifti-fifti, shih gjerësisht Buxhovi, Jusuf: “Kosova” I-V, Prishtinë, 2015, vëllimi III (*Perandoria Osmane*), faqe 430-441.

pretendimet e Greqisë ndaj jugut të Shqipërisë. Anglia në parim qëndronte neutrale, por dihej se Shqipërinë e konsideronte si një vend që duhej të ruante balancat rajonale dhe ato të sferave europiane të interesit në një pikë të ndjeshme të puqjeve midis Lindjes dhe Perëndimit, të cilave Londra pas largimit të Perandorisë Osmane, ua atribuonte rolin e urës lidhëse në kuptimin pozitiv, sadoqë Rusia dhe aleatët e saj, do të mundoheshin që atë ta kthenin në të kundërtën, pra në anatëmë të rrezikimit të qytetërimit të krishterë perëndimor me pandehmën se Shqiptarët me përkatësinë myslimane, në Europë futeshin si “*trup i huaj*” dhe i rrezikshëm për të madje, me çka ata i kthente në aktorë të “skenave” të kompleteve “*mbi bazat e luftës së qytetërimeve*”!

Anatema e tillë, që u vinte Shqiptarëve dhe çështjes së tyre nga Rusia dhe aleatët e saj nga Ballkani (Serbët, Malaziasit dhe Bullgarët), kishte për qëllim që ata të përjashtoheshin nga parimet bazë, ato të gjuhës dhe etnicitetit, të cilat Fuqitë e Mëdha i kishin shtruar si kritere për zgjidhjen e të gjitha çështjeve që hapte shpërbërja e Perandorisë Osmane në pjesën europiane, ku Shqiptarët shfaqeshin si njëri ndër faktorët kryesorë.

Konferenca e Ambasadorëve në Londër, ndonëse pa ndonjë përgatitje paraprake dhe ujdë që është e natyrshme në raste të tilla, filloi me dy qëndrime të ndërtuara që më parë, që mund të thuhet se ishin të imponuara nga diplomacia austro-hungareze dhe politika e saj, të cilat po ashtu ishin në përputhje me interesat e Lidhjes Trepalëshe. Dhe ato ishin:

a) rreth njohjes së ekzistencës së Shqipërisë, pa marrë parasysh statusi që duhej t’i caktohej, dhe

b) me pajtimin që vendet ballkanike fituese të luftës me Perandorinë Osmane, duhej të shpërbleheshin me territore, por jo në përmasa me kërkesat e tyre të plota, meqë kjo ngatërronte dhe madje rrëronte interesat e fuqive të mëdha europiane, ato të Lidhjes Trepalëshe, sidomos të Vjenës dhe Romës, të cilat nuk ishin të interesuara që ngopja e shteteve sllave të Ballkanit të shkonte në dëm të interesave të tyre, meqë ashtu forcohej edhe ndikimi rus në këtë pjesë të rëndësishme. Por, po ashtu bëri bërjen e Shqipërisë shtet e shihnin në (mos)përmbushjen e apetiteve të ndërsjella për shtrirje sa më të thellë në Ballkan, të cilat Shqipëria i pengonte.

Kundër forcimit të ndikimit rus në Ballkan ishte edhe Britania e Madhe po edhe Franca, që ndonëse luftonin çfarëdo përfitimi të Austro-Hungarisë në këto zhvillime, nuk mund të lejonin që ajo të përfitonte nga gjendja e re. Në këtë drejtim, Britania e Madhe, e cila mori përsipër rolin e “shpëtimtarit të paqes” që duhej të arrihej nëpërmes balancimit të interesave të Fuqive të Mëdha, u vu në

mbrojtje të një Shqipërie, e cila ishte e vetmja në gjendje që t'i ndihmonte këtij qëllimi, që për politikën e Londrës kishte rëndësi të madhe.<sup>1563</sup>

Këtu në të vërtetë ndodheshin edhe gjasat e mbijetesës së saj.

Për Shqipërinë, megjithatë, kishte rëndësi njohja e ekzistencës së saj qysh në fillim, pa marrë parasysh si do të bëhej kjo, meqë aty ndodhej edhe çelësi i zgjidhjeve të shumë çështjeve të tjera, që lidheshin drejtpërdrejt me fillimet e normalitetit, i cili nuk mund të rikthehej pa largimin e ushtrive të vendeve pushtuese, të cilat mbanin peng pjesën më të madhe të vendit nën rrethanat e gjendjes ushtarake. Po ashtu kishte rëndësi që të shkëputeshin që të gjitha lidhjet me Perandorinë Osmane, në mënyrë që hipoteka e saj të mos e ngarkonte të gjente vendin midis shteteve europiane. Por, si u pa në fillim, kjo jo vetëm që nuk do të ndodhë, por nisi edhe t'ia rëndojë kapërcimin nga Lindja në Perëndim. Rusia, madje, kishte deklaruar se *“ishte edhe në interes të vendeve europiane e edhe të vetë Shqiptarëve që të ruanin lidhjet me Perandorinë Osmane nga shkakut i pranimit të tyre në masë të islamit, i cili kishte ndikuar dhe ndryshuar edhe mentalitetin e tyre si popull”!*<sup>1564</sup>

Edhe Franca, nuk ishte gjithaq larg këtij mendimi, sado që arsyetimet e saj nuk ishin të natyrës “së civilizimeve”, por thjeshtë praktike, meqë sipas disa vlerësimeve që kishte nga diplomatët e saj në Stamboll *“organizimi shtetëror i Shqipërisë dhe administrata e saj gjithsesi duhej ruajtur diçka të traditës së gjatë shtetërore osmane, meqë ata në të kishin luajtur një rol të rëndësishëm”.*<sup>1565</sup>

Anatema e trashëgimisë osmane, që do të futet në përdorim, qoftë për pak dhe për arsye taktike në tryezën e gjelbër të Londrës, vazhdoi të funksionojë në mënyra të ndryshme dhe të marrë kah tek Shqiptarët në përputhje me vështirësitë që do t'i dalin shtetit shqiptar në rrugën e mundimshme të konsolidimit.

Kështu, qysh në seancën e parë, Konferenca e Ambasadorëve, më 17 dhjetor 1912, nën kryesinë e Sër Eduard Grej (Edward Grey), vendosi që *Shqipëria të ishte autonome nën sovranitetin ose suzerenitetin e Sulltanit dhe nën garancinë e kontrollin ekskluziv të gjashtë fuqive të mëdha.* Konferenca ngarkoi Austro-Hungarinë dhe Italinë të studionin dhe t'u propozonin fuqive të mëdha projektin mbi organizimin e shtetit autonom shqiptar.<sup>1566</sup>

---

<sup>1563</sup> Më gjerësisht rreth interesave të Britanisë së Madhe për shtetin shqiptar shih Guy, Nicola: *“Lindja e Shqipërisë”*, Tiranë 2012.

<sup>1564</sup> Zavalani, Tajar: *“Histori e Shqipërisë”*, Tiranë, 1998. Faqe 241.

<sup>1565</sup> Po aty, faqe 237.

<sup>1566</sup> Më gjerësisht shih: Swire, J: *“Albania, the Rise of a Kingdom”*, London 1929; Stickney, E. P: *“Southern Albania or Northern Epirus in European International Affairs 1912-1923”*, Stanford 1926; Pearson,

Në lidhje me kufijtë Konferenca vendosi në parim që Shqipëria autonome të kufizohej në Veri me Malin e Zi e në Jug me Greqinë. Me këtë vendim, duke caktuar si fqinj të veriut Malin e Zi, Fuqitë e Mëdha ia mbyllnin rrugën Serbisë për të dalë në Adriatik me aneksimin e territoreve në Veri të Shqipërisë. Roli i Austro-Hungarisë qe vendimtar dhe i pritshëm madje, meqë kështu përjashtohej mundësia që Serbia të dilte në det, dhe kjo mund të bëhej me anën e aneksimin të pjesës veriore, siç kishte ndodhur në të vërtetë, kur ushtritë e saj kishin depërtuar nga Shëngjini e deri në Durrës që ushtarakisht të paraprinin këtë pretendim. Por, nga ana tjetër, Serbisë iu njoh e drejta të kishte një dalje tregtare në det nëpër një skele shqiptare të lirë dhe asnjane. Ajo do të përdorej me anën e një hekurudhe ndërkombëtare, nën kontrollin europian dhe nën mbikëqyrjen e një force të posaçmendërkombëtare, me liri transiti për gjithë mallrat, duke përfshirë edhe municionet e luftës. Të nesërmen, më 18 dhjetor, këtij vendimi iu nënshtrua edhe qeveria serbe.<sup>1567</sup>

Vendimi i Konferencës së Ambasadorëve rreth njohjes, si thuhej të *Shqipërisë autonome nën sovranitetin ose suzeranitetin e Sulltanit dhe nën garancinë e kontrollin ekskluziv të gjashtë fuqive europiane*, në atë fazë të Konferencës ishte pritur dhe me të drejtë do të vlerësohet si hap taktik i Fuqive të Mëdha, që në njërin anë t'u japin kohë planeve të tyre të mëtejshme si duhej vepruar edhe me çështjet e tjera që i takonin kompleksitetit të trashëgimisë osmane. Në tjetrën anë, u bëhet me dije vendeve të Aleancës Ballkanike (Serbisë, Malit të Zi, Bullgarisë e Greqisë) se duhej pajtuar me faktorin shqiptar në Ballkan dhe shtetin e tyre të pavarur –Shqipërinë, pa marrë parasysh sa dhe si kishin luftuar kundër shfaqjes së saj, dhe si do ta parandalonin që të fitojë rëndësi në kuadër të sferave të interesit.

Megjithatë, *sovraniteti* ose *suzeraniteti* Sulltanit, po qe se do të mbetej, Shqipëria sërisht do të kthehej në mollë sherri në Ballkan. Kjo më së shumti do t'u shkonte për shtati atyre që kishin luftuar kundër shfaqjes së saj, të cilët edhe në të ardhmen do të luftonin kundër saj me arsyetimin se luftonin “*bastionin e fundit islamo-osman*” në Juglindje të kontinentit europian dhe madje këtë do ta kthenin në një misionarizëm të ri të krishterë gjoja në mbrojtje të qytetërimit

---

O: “*Albania in the Twentieth Century*”, London 2003; “*Historia e popullit shqiptar*”, vëll. III. Tiranë 2007, faqe 20.

<sup>1567</sup> Shih: Swire, J: “*Albania, the Rise of a Kingdom*”, London 1929; “*Historia e popullit shqiptar*”, vëll. III, Tiranë 2007, faqe 21; Puto, Arben: “*Pavarësia e Shqipërisë dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914*”, Tiranë 2012, faqe 142.

perëndimor, pikërisht siç e kishte kërkuar hegjemonizmi serbomadn në luftë kundër Shqiptarëve, që nga shfaqja e Serbisë së Garashaninit e këndeje.<sup>1568</sup>

Edhe pse nuk mund të thuhet se Qeveria e Vlorës një vendim të tillë nuk e kishte pasur parasysh dhe madje në përputhje me raportin e forcave dhe sferat e interesit midis Fuqive të Mëdha, në njëfarë mënyre edhe e kishte pritur, që së paku të futej në lojë si testim apo edhe instrument amortizues. Fillimisht ajo do ta kundërshtojë dhe me të drejtë madje, ani pse pak më vonë, do të jetë vetë Ismail Qemali që do të futet në disa marrëveshje të fshehta me Xhonturqit rreth rolit të tyre në kryengritjen kundër pushtuesve serbë, që ndonëse do të dështojë, ata do t'i fusë sërish në lojë për të vazhduar edhe më vonë përzjerja e tyre me pasoja të rënda për vendin dhe fatet e tij.

Por, kur jemi te formulimi nismëtar i Konferencës së Ambasadorëve në Londër i 18 dhjetorit 1912, pra kur Shqipëria do të shpallej *autonomi nën sovranitetin ose suzeranitetin e Sulltanit*, me interes për atë fazë për Shqipërinë ishte *theksimi i garancive dhe i kontrollit ekskluziv të gjashtë Fuqive të Mëdha* ndaj saj, gjë që kishte rëndësi dhe Qeverisë së Vlorës do t'i shkojë përshtati. Sepse, Fuqitë e Mëdha i ngarkonte me përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të mbikëqyrjes së gjendjes në gjithë vendin, të cilën qeveria e Vlorës nuk mund ta bënte edhe po t'i jepej mandati i qeverisjes, siç do t'i ngarkojë edhe me përgjegjësinë e largimit të ushtrive pushtuese jashtë vijave që Konferenca do t'i caktojë si kufi të Shqipërisë pa marrë parasysh sa dhe si ata ishin të natyrshëm.

Me këtë, do të fillojë koha e mbajtjes së Shqipërisë nën mbikëqyrjen ndërkombëtare, me disa faza, e cila vendin nuk do ta nxjerrë nga terapia e krizës në të cilën do të gjendet, por njëherësh do t'ia heqë rrezikun e zhbërjes si shtet, siç dëshironin dhe vepronin fqinjët e saj. Kjo terapi, madje, do të vazhdojë në forma të ndryshme nga koha në kohë, duke bërë të ditur, në njërën anë për rëndësinë e madhe ndërkombëtare të Shqipërisë në konfigurimin rajonal, dhe në tjetrën anë duke nxjerrë në pah dobësitë po edhe paaftësitë e vetë Shqiptarëve që të marrin përsipër fatet e vendit të vet duke u bërë pjesë e lojërave të të tjerëve.

Megjithatë, njohja e Shqipërisë, qoftë edhe si autonome dhe nën *sovranitetin ose suzeranitetin e Sulltanit*, Fuqive të Mëdha nuk do t'ua heqë mundimin e saj dhe të marrjes drejtpërdrejtë me të. Përkundrazi, do të shihet se ajo që për dy muaj do të merret si *sovranitet ose suzeranitet i Sulltanit*, problematikës së saj jo vetëm që nuk do t'i ndihmojë, por edhe do t'i kthehej në handicap të madh. Se-

---

<sup>1568</sup> Shih: Morwat, R.B: "A History of European Diplomacy 1914-1925", London 1927; Marmullaku, Ramadan: "Albania and the Albanians", London 1975.

pse, në njërin anë - nga brenda, midis Shqiptarëve do të ringjallë konfrontimet mbi frymën islamiste proturke, ndërsa nga tjetra anën - nga jashtë, nga vendet fqinje (Serbia, Mali i Zi dhe Greqia), *sovrانيتeti ose suzerانيتeti i Sulltanit*, do të shfrytëzohej, që ajo në forma të ndryshme të destabilizohej dhe kështu nga pamundësia të konsolidohej, t'u shkonte përshtati që të zgjeroheshin me viset Shqiptare dhe me këtë edhe më tutje të rritej ndikimi i Rusisë në Ballkan. Po ashtu, Shqipëria autonome nën *sovrانيتetin* apo *suzerانيتetin* e Sulltanit, nuk do të mund ta kishte vulën e ndikimit të Austro-Hungarisë dhe vendeve të Lidhjes Trepalëshe, siç do ta kishte një Shqipëri autonome jashtë lidhjeve me Perandorinë Osmane.

Edhe duke u anashkaluar çështja e sovranitetit ose suzeranitetit të Sulltanit, përderisa do të hiqet fare me vendimin e 29 korrikut 1913 kur Konferenca e Londrës, më në fund, do të pranojë projektin për organizimin e shtetit shqiptar, sipas të cilit *Shqipëria shpallej principatë autonome, sovrane e trashëgimore, me ç'rast i hiqej çdo lidhje suzeraniteti me Perandorinë Osmane*, nuk do të thotë njëherësh edhe heqje e hijes osmane. Sepse, si do të shihet, edhe për një kohë të mirë ajo do ta ndjekë pareshtur deri aty sa që Shqipëria do të dominohej nga kryengritje anti-europiane, që zhvilloheshin me kërkesat për t'iu bashkuar Turqisë. Ajo që tashmë shfaqej si Shqipëri Osmane, së paku si e përkohshme dhe me hipoteka antihistorike, luftonte për jetë a vdekje kundër Shqipërisë europiane, luftë kjo në të cilën ishin përfshirë Shqiptarët, por frenat e së cilës i mbanin kundërshtarët e saj, pra fqinjët sllavë dhe grekë të drejtuar nga Rusia ortodokse, që kishin shumë arsye që Shqipëria të binte pre e vetëshkatërrimit nga brenda dhe mbi këto baza.

Madje, edhe *kriza e Shkodrës*, ajo e *Janinës* dhe *çështja e Kosovës*, si tri pika të nxehta rreth të cilave do të përqendrohet e gjithë vëmendja e Konferencës së Ambasadorëve, dy prej tyre do të lidhen drejtpërdrejt me pasojat e pranisë osmane në luftërat për mbrojtjen e tyre. Kështu, Kosova dhe kryengritjet e Shqiptarëve kundër pushtimit serb gjatë dhe pas mbajtjes së Konferencës së Ambasadorëve në Londër, nuk do të jenë të liruara nga implikimi i Xhonturqve, dhe përpjekjeve të tyre herë të hapura e herë të fshehura, që të shfrytëzojnë për qëllime të veta tragjedinë shqiptare, së cilës pikërisht ata i kishin ndihmuar të shfaqej e tillë.

Kriza e Shkodrës dhe ajo e Janinës, të cilat fillimisht do të paraqiten si çështje të natyrës ushtarake, pra ku në të parën - edhe më tutje do të luftohej midis forcave malaziase dhe osmane bashkë me ato mbrojtëse shqiptare, dhe në të dytën – forcat osmane do të luftojnë kundër forcave greke, ku po ashtu do të shfaqen mbrojtësit shqiptarë dhe patriotët vullnetarë me thirrjen e Qeverisë së Vlorës - do



të marrin karakterin e luftës midis “çlirimtarëve” dhe “pushtuesve”, ku “çlirimtarët” shpërbleheshin, ndërsa “pushtuesit” dënoheshin!

Sigurisht se raporti midis “çlirimtarëve” në këtë rast ushtrive serbe, malaziasë dhe greke, dhe “pushtuesve” – armatës osmane, do të sqarohet fare lehtë, po mos të shfaqeshin Shqiptarët në rolin e mbrojtësit të vendit të vet nga “çlirimtarët”, që automatikisht ktheheshin në pushtues të rinj, që në njëfarë mënyre i kthente edhe në aleatë të atyre që luftoheshin si pushtues!

Ky “ndërlikim” ndonjëherë i pakuptueshëm nga jashtë dhe qëllimisht i ngatërruar nga kundërshtarët e Shqipërisë, kishte për qëllim që lufta kundër mbetjeve të Perandorisë Osmane në Europë, ku në pjesën më të madhe përfshiheshin viset etnike shqiptare, të shfrytëzohej si “alibi” e dyfishtë kundër Shqiptarëve dhe interesave të tyre: në njërën anë që viset e tyre të pushtoheshin nën pretekste se kundër pushtuesit osman bëhej luftë çlirimtare, gjë që teorikisht ishte kështu, dhe në anën tjetër, Shqiptarët praktikisht të anatemoheheshin si pjesëmarrës dhe bashkëluftëtarë të ushtrive pushtuese osmane kundër “çlirimtarëve”!

Shkodra dhe Janina, sidomos kjo e para, paraqitnin shembullin më tipik të këtij ndërlikimi, i cili mund të thuhet se nuk ishte jashtë disa skenarëve nga jashtë, që të shfrytëzoheshin për qëllime të caktuara nga ato të mbajtjes “si çështje rezervë” dhe të monedhës për kusuritje, e deri tek shpërqendrimi i vëmendjes nga pikat e caktuara, të një rëndësie jetike, siç ishte Kosova, ku zhvillohej një gjenocid i tmerrshëm ndaj popullatës së atjeshme shqiptare nga forcat pushtuese serbe dhe malaziasë, me çka ajo anashkalohej.

Se çështja e Shkodrës ishte e një natyre të tillë, kjo nuk do mend. Ka shumë shenja që e vërtetojnë atë. Vetë fakti se ajo do të ashpërsohet çastin që Konferenca e Ambasadorëve në Londër, më 22 mars 1913, nën presionin e Austro-Hungarisë dhe të Italisë kategorikisht do të refuzojë propozimin e Rusisë që Shkodra t’i shkëputej Shqipërisë dhe t’i jepej Malit të Zi, këtë e dëshmon më së miri. Sepse, do të jenë Rusia dhe Serbia ato që do ta nxisin drejtpërdrejt Mbretin Nikollë që të fillojë bllokadën e Shkodrës nën euforinë e parullës nacionaliste: “*Shkodra, apo vdekja*”, si trysni që në njërën anë të mbroheshin pushtimet serbe në Kosovë dhe Maqedoni dhe njëherësh të krijoheshin mundësi për të çara të tjera midis vetë Shqiptarëve (këtu llogaritej në faktorizimin e Esat Pashë Toptanit dhe rolit të tij në Shkodër), me çka Vjena dhe Roma do të përballeshin me vështirësi rreth mbështetësve të tyre, të cilët duhej të merrnin përgjegjësinë e qeverisjes së Shqipërisë. Kjo përçarje e paraparë, do të shihet se ishte menduar mirë dhe për të ishte punuar shumë nga ana e Beogradit, Cetinës në bashkëpunim me

Rusinë, kur Esat Pashë Toptani do të futet në lojë si në raport me jashtë, pra me ndërkombëtarët, ashtu edhe me vetë Shqiptarët.<sup>1569</sup>

Esat Pashë Toptani, doli “në skenë” si “*faktor autonom shqiptar*” çastin që vritet komandanti i garnizonit të Shkodrës, Hasan Riza Pasha. Thuhet se ai mund të kishte dorë në këtë vrasje, meqë ishte i vendosur që bashkë me mbrojtësit shqiptarë të mos e dorëzonte Shkodrën, mbrojtja e së cilës, ishte edhe në interesin e Austro-Hungarisë, e cila luftonte që ajo t’i mbetej Shqipërisë. Për aq kohë sa ajo nuk do të kapitullonte dhe do të mbrohej nga Shqiptarët dhe jo nga fantazmat mesjetare, vërtetonte tezën se fjala ishte për një vend shqiptar dhe jo për kryeqendër të imagjinuar malaziasë. Duke parë se Mali i Zi i ndihmuar nga forcat serbe nuk kishte ndërmend të ndërpriste bllokadën e Shkodrës dhe me këtë Konferenca rrezikohej ta humbte autoritetin për t’u kthyer në një instrument të qëllimeve serbe-malaziasë, Austro-Hungaria kërcënoi Rusinë se nëse Mali i Zi dhe Serbia do të vazhdonin luftën kundër Shkodrës, atëherë trupat e saj do të marshonin drejt Sanxhakut për në Shqipëri të Veriut dhe në Kosovë, në mënyrë që prej atje të siguronin mbrojtjen e Shqiptarëve nga sulmet serbo-malaziasë.<sup>1570</sup>

E frikësuar nga kërcënimi austro-hungarez dhe nga pasojat që do të mund të kishte kjo për gjithë atë që ishte arritur deri më atëherë në Konferencë në dobi të aleatëve të saj sllavë, Rusia do të pranojë demonstrimin detar të flotës së fuqive europiane para bregdetit malazias. Më 5 prill skuadra detare ndërkombëtare, nën komandën e nënadmiraletit anglez Ser Sesil Burnej (Cecil Burney) arriti pranë Tivarit dhe pas disa ditësh bllokoi detin prej Tivarit deri në grykën e Drinit. Malaziasit edhe pas këtij demonstrimi detar nuk pranuan ta zhblokojnë Shkodrën. Por, pasi që Austro-Hungaria vuri forcat e veta në gjendje lufte dhe ishte e gatshme t’i niste për në Sanxhak, Serbia u pajtua t’i tërheq trupat e veta dhe këtë e bëri më 12 prill. Pa forcat serbe, ishte e qartë se ushtria e Malit të Zi, nuk ishte në gjendje ta merrte Shkodrën. Por, për ta bërë këtë ajo zgjodhi Esat Pashë Toptanin dhe ambiciet e tij për t’u bërë “mbret” i Shqipërisë sipas kutit serbo-rus, i cili vendosi që të hyjë në marrëveshje me vendet e Antantës për t’ua dorëzuar qytetin.

---

<sup>1569</sup> Rreth rolit të Esat Pashë Toptanit në krizën e Shkodrës si dhe përpjekjeve të tij për aleanca të ndryshme politike dhe diplomatike shih: Poincare, Reymond: “*Lufta e Parë dhe e Dytë Ballkanike si dhe Konferenca e Londrës 1912-1913*”, Tiranë; Puto, Arben: “*Pavarësia e Shqipërisë dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914*”, Tiranë 2012, faqe 444, 479; Wilhem zu Wied: “*Dektschrift über Albanien*” te Buxhovi, Jusuf „*Nga Shqipëria Osmane te Shqipëria Europiane*”, Prishtinë 2010, faqe 543-574; Guy, Nicola: “*Lindja e Shqipërisë*”, Tiranë 2012, faqe 122-133.

<sup>1570</sup> Shih “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëll. III, Tiranë 2007, faqe 36.

Paraprakisht bëhet e ditur se Toptani kishte kërkuar që të vente lidhje me përfaqësuesit e Lidhjes Trepalëshe, por ishte refuzuar prej tyre me arsyetimin se nuk i besohej pasi që tashmë ishte futur në lojë me Serbët dhe Rusët. Që të mbetet edhe më tutje “i rëndësishëm” dhe në lojë, Toptani, më 22 prill 1913, nënshkroi një marrëveshje me Malaziasit për dorëzimin e qytetit. Bashkë me trupat osmane dhe mbrojtësit shqiptarë si dhe me municionin që kishte me vete u largua në drejtim të Shqipërisë së Mesme, ku do të shpallë feudin e tij dhe prej nga do të vazhdojë të punojë për interesat e veta, pavarësisht sa dhe si mund ta dëmtonin çështjen e saj.<sup>1571</sup>

Pas shtatë muaj luftimesh, ushtria malaziasë hyri në Shkodër dhe zuri të kremtonte “fitoren historike”, e cila qytetit i kushtoi shumë viktima nga regjimi ushtarak malazias, veçmas ndaj patriotëve dhe qytetarëve të Shkodrës. Më 28 prill, siç pritej, pa marrë pëlqimin e Fuqive të Mëdha, Vjena do të reagojë me kërcënimin se nëse brenda një jave Mali i Zi nuk do të tërhiqte trupat pushtuese nga Shkodra, Austro-Hungaria bashkë me Italinë do të vepronin ushtarakisht për ta vënë nën mbikëqyrje gjithë Shqipërinë. Një kërcënim i ngjashëm iu bë edhe Perandorisë Osmane, e cila pasi që më 19 prill kishte nënshkruar marrëveshjen e paqes me vendet ballkanike dhe praktikisht kishte hequr dorë edhe nga çfarëdo lidhje me Shqipërinë, duhej të mos përzihej më në punët e Shqipërisë dhe me të shpejtë t’i tërhiqte trupa prej andej.<sup>1572</sup>

Kërcënimi i Austro-Hungarisë, si dhe përgatitjet e saj bashkë me Italinë për të marshuar në gjithë Shqipërinë, e shqetësuan seriozisht Rusinë, e cila e kishte më se të qartë se shpërthimi i një lufte të re me Lidhjen Trepalëshe ishte në prag dhe se ajo nuk e dëshironte. Por, kjo do të shqetësojë edhe Francën dhe Anglinë, të cilat do të kërkojnë nga Rusia me të shpejtë të marrë masa për të qetësuar gjendjen. Kështu, dy ditë para se të kalojë ultimatumit i Vjenës, Rusia do ta detyrojë Malin e Zi të pranojë tërheqjen e trupave të veta nga Shkodra dhe këtë ta bëjë publikisht.<sup>1573</sup>

Ushtria e Malit të Zi u largua nga Shkodra më 14 maj 1913, pas një qëndrimi prej tri javësh dhe pasi që plaçkiti çdo gjë të vlefshme të saj dhe dogji edhe pazarin e vjetër. Në qytet hyjnë fuqitë ndërkombëtare. Administrata e qytetit kaloi në dorë të një komisioni ushtarak të kryesuar nga Sesil Burnje dhe të përbërë prej

---

<sup>1571</sup> Po aty.

<sup>1572</sup> Më gjerësisht shih: Poincare, Reymond: “Lufta e Parë dhe e Dytë Ballkanike si dhe Konferenca e Londrës 1912-1913”, Tiranë, faqe 432, 469, 472 dhe 474.

<sup>1573</sup> Po aty.

oficerësh të flotës që kishte bllokuar bregdetin. Komisioni ndërkombëtar nuk lejoi të ngrihej në Shkodër flamuri i Shqipërisë dhe nuk e përfilli Qeverinë e Vlorës. Në qytet vendosi një administratë kantonale,<sup>1574</sup> me çka do t'i hapen dyert praktikës së ndërhyrjeve të herë pas hershme ndërkombëtare në Shqipëri. Por, si do të shihet, qyteti i Veriut, i udhëhequr nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollitdo të kursehet nga vështirësitë me të cilat do të ballafaqohen pjesët tjera të Shqipërisë deri sa do të fillojë Lufta e Parë Botërore.

Ndërhyrja ndërkombëtare në Shkodër që t'i jepej fund pushtimit malazias, shënon demonstrimin e parë ushtarak të Perëndimit në anën e Shqiptarëve në konflikt me malaziasit.

Por, Shkodra dhe nxjerrja e saj nga pushtimi i huaj (në këtë rast ai malazias) nuk do të përsëritet në Janinë. Edhe ajo thuajse kishte të njëjtin skenar shpërthimi dhe ashpërsimi, por ndryshonin aktorët dhe rolet si dhe ndryshonin interesat e Fuqive të Mëdha. Fjala ishte për të njëjtën çështje, pra të mbrojtjes së një qyteti shqiptar, por tash në Jug të vendi, ku forcave osmane, krahas mbrojtësve që prej kohësh ishin përfshirë në luftime, do t'u shkojnë në ndihmë edhe vullnetarët e tjerë dhe kjo do të bëhet me vendimin e Qeverisë së Vlorës të 28 janarit 1913.

Ky vendim, megjithatë, shfaqej i diskutueshëm si nga aspekti politik dhe ai ushtarak dhe do të ketë për pasojë që Janinën dhe viset e tjera përreth që t'i fitojë Greqia më shumë “nga e drejta se kishte bërë luftë çlirimtare kundër pushtuesit osman” se sa nga e drejta etnike, të cilën nuk e kishte, meqë popullata e Janinës dhe viseve të tjera përreth në shumicë ishte shqiptare dhe kjo nuk kontestohet as nga përkrahësit e saj.

Edhe pse dihet pretendimet greke ndaj Jugut të Shqipërisë, megjithatë, vendimi i Qeverisë së Vlorës që të përfshihet në luftë, qoftë edhe mbrojtëse në anën e Perandorisë Osmane kundër Greqisë, aty për aty e bënte të anshme, madje e vendoset në anën e humbësive të pashmangshme, siç ishte Perandoria Osmane në ato çaste, ani pse ditë më parë e njëjta qeveri do të shpallë neutralitetin e vet në luftë, duke u kufizuar vetëm tek mbrojtja e domosdoshme në rast kur kërcënoheshin Shqiptarët nga ushtritë ballkanike.

S'do mend se Qeveria e Vlorës kur kishte marrë një vendim të tillë kishte pasur parasysh aspektin patriotik të mbrojtjes së trojeve të veta, paçka se kjo hapë me të drejtë dilemën si dhe sa iu ndihmua ruajtjes së territoreve shqiptare, kon-

---

<sup>1574</sup> Po aty, faqe 375.

kretisht Janinës dhe pjesës së Gjirit të Prevezës me pjesëmarrjen në anën e ushtrisë osmane, në vend se të zgjidhej ndonjë strategji tjetër?

Hiq arsyet patriotike, të cilat në rrethana të tilla, justifikojnë shumëçka, ani pse nuk ndihmojnë gjithaq, të tjerat shfaqen të paqëndrueshme.

Nëse qëndrimet e Qeverisë së Vlorës rreth pjesëmarrjes në luftë në anën e forcave osmane për të mbrojtur Janinën dhe viset e tjera shqiptare në Jug shfaqen të diskutueshme, jo për nga ana morale por nga ajo e pasojave, megjithatë, çështja e Kosovës dhe mbrojtja e saj, qeverinë e Vlorës e solli para akteve të kryera, ngaqë me asgjë nuk mund t'i ndihmonte çlirimit të saj nga pushtimet serbe si dhe tragjedia që i solli ajo.

Ndonëse Kosova dhe mbrojtja e saj nuk do të kthehen në front gjithëpërfshirës shqiptar në bërjen e Shqipërisë, ajo megjithatë, në planin politik dhe diplomatik, në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, do të kthehet në një betejë të hapur, në njërën anë, midis të “drejtës historike”, që e kishin sajuar Serbët prej kohësh dhe e shfrytëzonin për ta paraqitur atë “*si kthim në djepin shpirtëror mesjetar serb*”, dhe në tjetrën - të drejtës etnike, si e drejtë jetësore, që e posedonin Shqiptarët. Kështu që, në Londër, çështjen e parë (“të drejtën historike”serbe) e mbronin Rusët. Ndërsa të dytën, (të drejtën etnike shqiptare), pak a shumë, e mbronin Austro-Hungarezët. Ata lanë për të kuptuar se nuk ishin për zbatim absolut e pikë për pikë të këtij parimi, meqë ishin rezultatet e luftës së Aleancës Ballkanike kundër Perandorisë Osmane, që shfaqeshin si fakte të kryera me dhunë, të cilat nuk mund të injoroheshin qind për qind.

Përfaqësuesi i Vjenës në Londër deklaroi në fund të dhjetorit se “*tokat e banuara krejtësisht nga popullsia shqiptare nuk duhej t'i shkëputeshin Shqipërisë*”, ndërsa krahinat ku Shqiptarët mund të përbënin shumicën e popullsisë, mund të ishin objekt i kompromisit ndërmjet Fuqive të Mëdha dhe mund të përdreshin për të plotësuar aspiratat e shteteve fqinje. Andaj, ishte e natyrshme që mbi këtë kompromis të pritej edhe njohja e Shqipërisë.

Këto qëndrime skajshmërisht polarizuan Austro-Hungarinë me Rusinë, kur mbi këto parime shfaqen propozim-hartat e tyre rreth kufijve të Shqipërisë. Sepse, në njërën anë do të jetë parimi etnik, ai që në masë të madhe do të udhëheqë qëndrimin e Vjenës dhe Shqipëria propozohej të përfshinte thuajse pjesën më të madhe të territoreve ku popullata përbënte shumicën (me përjashtim të një pjese të Kosovës Qendrore dhe asaj Lindore, e cila megjithatë, jashtë shtetit shqiptar lente Prishtinën dhe Shkupin), të cilën Austro-Hungaria e mbrojti që nga fillimi. Dhe, në tjetrën anë, shfaqej Rusia me qëndrimin që Shqipëria, pa Kosovën dhe

viset e tjera në Maqedoni, të kufizohej në një principatë të vogël pa kurrfarë mundësish mbijetimi.

Harta e Austro-Hungarisë që iu paraqit Konferencës ishte një projekt për diskutim, që nga pikëpamja e interesave shqiptare, shfaqej optimale. Kështu, vija kufitare në Veri kalonte përgjatë Bunës, duke ndjekur drejtimin e vjetër të kufirit të Malit të Zi me Perandorinë Osmane deri afër Rrzhanicës dhe prej këtej vazhonte në trajtë gjysmërrethi dhe, duke kaluar në Jug të Gucisë e të Plavës, merrte drejtimin në afërsi të Pejës, Gjakovës, Prizrenit që përfshiheshin në Shqipëri. Nga Prizreni kufiri zbriste në Jug dhe mbërrinte në malet midis liqenit të Ohrit dhe atij të Prespës, duke i përfshirë qytetet e Dibrës e të Ohrit brenda tokave shqiptare. Më tej, drejt jugut e juglindjes, kufiri linte Korçën dhe Janinën në anën e Shqipërisë dhe në fund ndiqte vijën e lumit Kalamas për të dalë në detin Jon, në Jug të ishullit të Korfuzit.<sup>1575</sup>

Duke u mbështetur mbi të “*drejtën historike*” të sajuar nga historiografia serbe dhe kisha ortodokse ruse-serbe dhe me arsyetimin se ajo ishte “*qendër mesjetare serbe*”, ku kishin zanafillën mbretërit serbë dhe historia kishtarë serbe dhe me parulla të ngjashme që moti të fabrikua nga hegjemonizmi serb, siç pri-tej, Rusia doli me propozimin që Kosova e Maqedonia t’i takojnë Serbisë. Ndërsa vija e kufirit në Veri të kalonte nga deti Adriatik afër rrjedhës së Drinit, drejtohej në Lindje deri te bashkimi i Drinit të Bardhë me Drinin e Zi dhe prej andej, gjatë rrjedhës së Drinit të Zi, deri te liqeni i Ohrit. Kufiri kalonte pastaj në Jug dhe kthehej drejt Perëndimit për të dalë në detin Jon te kepi Qafali, duke lënë jashtë Shqipërisë Korçën, Delvinën dhe Sarandën. Krahasuar me hartën e Austro-Hungarisë, shikuar nga interesi shqiptar, harta ruse shfaqej minimale.

Kishte edhe një hartë të tretë, atë të vendeve ballkanike, që Shqipërinë e rrudhte edhe deri te përmasat e një krahine të ngushtë bregdetare, pa Lezhën, e cila shkonte deri te Vlora.

Harta e katërt, ishte ajo e Qeverisë së Vlorës, e cila përshinte të gjitha trojet etnike shqiptare në të dhe arsyetohej mbi këtë parim dhe shfaqej maksimale. Kjo hartë nuk u shqyrtua fare në Konferencë.<sup>1576</sup>

Historia e hartave që do t’i paraqiten Konferencës së Ambasadorëve në Londër dhe njëra prej tyre, ajo që do të shpallet më 29 korrik 1913, do të jetë zyrtare,

---

<sup>1575</sup>Puto, Arben: “*Pavarësia e Shqipërisë dhe Diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914*”, Tiranë 2012, faqe 241; Shih: Guy, Nicola: “*Lindja e Shqipërisë*”, Tiranë 2012, faqe 53-59; “*Historia e popullit shqiptar*”, vëll. III. Tiranë 2007, faqe 22.

<sup>1576</sup> Shih: Puto, Arben: “*Pavarësia e Shqipërisë dhe Diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914*”, Tiranë 2012, faqe 291-297.

në të vërtetë, nxjerrë në pah historinë e lindjes së shtetit shqiptar të prerë me gërshërë në tavolinën e gjelbër të Fuqive të Mëdha, bashkë me të gjitha ato që do t'i ndihmojnë që ai të dalë i përgjysmuar, pa harruar mundësinë se po të mos kishte pasur edhe përkrahës, siç ishte Austro-Hungaria e ndihmuar nga Italia dhe Gjermania, ka mundur të fshihet fare. Ndërkohë çështja shqiptare do të mbetet e pazgjidhur, si një potencial i madh krize, që si do të shihet, do të vazhdojë të mbetet pjesë e dridhjeve ballkanike për të ardhur deri në kohën tonë, pse Fuqitë e Mëdha europiane, edhe përkundër faktit se do ta pranojnë Shqipërinë shtet në përmasat e njohura, kjo nuk do të bëhet mbi parimet e të drejtës etnike dhe asaj jetësore, por mbi ato të *“të drejtës historike”*.

Mbi këto parime, dhe veçmas mbi atë *“të të drejtës së fryteve të luftës”*, Serbisë do t'i jepet Kosova dhe një pjesë e mirë e Maqedonisë. Ngjashëm do të veprohet edhe me rastin e Janinës dhe të viseve të tjera shqiptare në jug, pa çarë kokën pse pikërisht mbi këto “parime” popullata etnike shqiptare e mbetur jashtë kufijve të shtetit shqiptar, në Veriperëndim dhe në Jug, ndonëse në shumë pjesë në shumicë, do të kthehet në minoritet.

Por, gjendja e re, që solli pushtimi si dhe përligjja e saj nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër, nuk u pranua nga shqiptarët që mbetën nën pushtimin serb, malazias dhe grek. Patriotët shqiptarë, kryesisht nga Kosova, që kishin udhëhequr kryengritjet e mëdha të Kosovës të viteve 1908 kur kishin sjellë në pushtet Xhonturqit dhe më 1911 dhe në verën e vitit 1912 do të ngrihen kundër tyre dhe me Memorandumin e Shkupit prej 14 pikash të 24 korrikut do të detyrojnë Portën e Lartë që t'ua pranojë kërkesat e tyre, pasi do të marrin mësim nga pësimi tragjik që e kishin nga mendjehetësia e veprimeve me të cilat kishin shpërndarë kryengritjen popullore dhe me këtë ishte zbratur një akumulim i energjisë kur nuk duhej, do të përpiqen për një kryengritje tjetër të Kosovës. Por tash kundër forcave pushtuese serbe dhe malazias, të cilat pas vendimeve të korrikut të Konferencës së Londrës në mënyrë që të mos u pranoheshin “tapitë” e Kosovës.

Ishte kjo një përpjekje më shumë dëshpëruese dhe me rreziqe të dyanshme se sa veprim që premtonte ndonjë sukses. Hasan Prishtina, Bajram Curri, Isa Buletini dhe të tjerë nga Lëvizja Kombëtare, pasi që Konferenca e Ambasadorëve në Londër të marrë vendimet e njohura, do të mblidhen në disa pjesë të Shqipërisë për të organizuar kryengritje. Bënin hesap tek ata që tashmë ishin detyruar të lëshonin trojet, por edhe të vullnetarët shqiptarë brenda dhe jashtë vendit e sidomos te ata që kishin mbetur në trojet e tyre dhe kishin shumë arsye që të mos e pranonin pushtuesin e ri. Ata nuk do të pranojnë as vendimet e Konferencës së

Ambasadorëve, por njëherësh nuk do të respektojnë as obligimet e Qeverisë së Vlorës që të mbetet neutrale ndaj çfarëdo veprimi ushtarak jashtë kufijve të pranuar nga fuqitë e mëdha europiane.

Që të mos linte përshtypjen e përfshirjes në Kryengritjen e Kosovës, Qeveria e Vlorës, në shtator të vitit 1913 Hasan Prishtinën, e emëron ministër, ani pse mund të krijohej edhe bindja tjetër, se Ismail Qemali këtë e kishte bërë qëllimisht që lëvizjes irredentiste, së paku nga brenda, t'i jepte njëfarë legjitimiteti. Sidoqoftë, interesim për Kryengritjen e Kosovës, do të tregojë edhe qeveria e Vjenës, e cila në mënyrë të tërthortë do t'u ofrojë përkrahje kosovarëve, ngase kryengritja në viset e pushtuara shqiptare prej Serbisë, do t'ia dobësonte pozitën Beogradit që të mos orientohej gjithaq për të përkrahur lëvizjet irredentiste në Bosnje dhe Hercegovinë, të cilat po bëheshin gjithnjë e më luftënxitëse kundër pranisë austriake në këtë vend, dhe si do të shihet pas një viti, me atentatin e nacionalistëve serbë kundër princit Franc Ferdinand në Sarajevë, do t'i hapet rruga Luftës së Parë Botërore, e cila do të fillojë me hyrjen e Austrisë në luftë me Serbinë.<sup>1577</sup>

Ka gjasa që edhe Serbia të kishte interes te kjo kryengritje. Disa burime arkivore madje flasin se disa nga agjentët e saj të infiltruar në radhët e kryengritësve shqiptarë shpërndanë të holla dhe armë në pjesët e Dibrës dhe të Gjakovës dhe do të marrin detyra nga Beogradi se cilat vise duhet doemos të përfshiheshin në kryengritje. Sepse, si do të shihet, Serbisë i duhej një shkak për t'i arritur tri qëllime njëherësh:

*Së pari* - që kryengritjen e popullatës së Kosovës dhe të viseve të Maqedonisë, që i kishte fituar tashmë në Londër, ta shfrytëzonte që me një terror tjetër ndaj pjesës së mbetur shqiptare, të cilin tash do ta bënte në emër të mbrojtjes së hapësirës së vet shtetërore, të nxiste edhe një valë shpërnguljesh të tyre drejt Shqipërisë, gjë që viset e pushtuara do të vazhdonin të pastroheshin etnikisht deri në atë masë sa të ishin të gatshme për kolonizim të shpejtë siç ishte paraparë nga Beogradi;

*Së dyti* - synonte që pushtimet e legjitimuara t'i korrignonte dhe plotësonte edhe me disa pika të tjera strategjike drejt Shqipërisë, të cilat do të shpallehin “si zona të sigurisë” ;

*Së treti* - të rrëzonte Qeverinë e Vlorës dhe në vend të saj të sillte Esat Pashë Toptanin, me të cilin mbante lidhje shumë të mira dhe dukej se me të ishin bërë disa hesape, edhe pse ai në ndërkohë do të jetë futur në Qeverinë e Vlorës si ministër i mbrojtjes, pikërisht që t'i ndaleshin marifetet.

---

<sup>1577</sup> Po aty, faqe 48.



Pa marrë parasysh hesapet rreth asaj se kujt i ishte dashur më shumë dhe kush i kishte futur gishtat në të për qëllime të caktuara, kryengritja e Shqiptarëve kundër forcave pushtuese serbe shfaqej si kundërpërgjigje e drejtë gjendjes së pushtimit, që nuk duhej pranuar assesi. Si e tillë ajo filloi nga gjysma e dytë e shtatorit në Dibër, pastaj vazhdoi në Strugë dhe Ohër për t'u përhapur edhe në Tetovë dhe në drejtim të Kosovës, ku do të përfshijë Prizrenin dhe Gjakovën.

Serbia, pas disa humbjeve nismëtare, që dukej se ishin të llogaritura, të cilat me të shpejtë do t'i shfrytëzojë për mobilizim të brendshëm nacionalist të përmasave të gjera, shpejt do ta marrë veten dhe në fillim të tetorit nisi kundërsulmin e madh në tri drejtime me njësi të përforcuara dhe armatim të shumtë. Do të përfshijë edhe topa kalibrash të mëdha, të cilët pamëshirshëm do të bombardojnë dhe rrënojnë vendbanimet nga Pollogu i Maqedonisë e deri në pjesët e skajshme të Dukagjinit duke bërë një terror të madh ndaj pikave të caktuara dhe shumë më të egër nga ai para një viti kur ishin shfaqur në luftë me forcat turke. Pas pak trupat serbe do të futen edhe në pjesët e brendshme të Shqipërisë në drejtim të Tiranës dhe të Durrësit me çka do të hapen dyshimet e drejta se ajo kishte pritur një shkas të tillë.

Pas gjithë kësaj, sërish do të shfaqet Vjena e cila do ta pengojë Serbinë që të arrijë ato që kërkonte pas shuarjes me gjak të kryengritjes së Maqedonisë dhe të Kosovës. Më 18 tetor ministri i jashtëm austriak Berhtold, për të dytën herë brenda gjashtë muajve, i dërgoi Beogradit një ultimatum që të tërheqë trupat e veta nga Shqipëria brenda tetë ditësh ose do të ballafaqohet me luftën me Austro-Hungarinë.<sup>1578</sup>

E këshilluar nga Franca dhe Rusia, Serbia tërhoqi me të shpejtë forcat ushtarake nga Shqipëria, por ato do të forcohen edhe më tutje në Kosovë për të ushtruar terror ndaj popullatës së pambrojtur. Tash këtë mund ta bënin pa ndonjë vështirësi dhe rrezik që të ballafaqoheshin me ultimatimet e Vjenës, meqë kishin “tapitë” e Konferencës së Ambasadorëve të Londrës, me të cilat ata mund të përdornin luftën sa herë të donin në emër të mbrojtjes së sovranitetit dhe të integritetit shtetëror nga forcat separatiste shqiptare.

Megjithatë, liderët nga Kosova që kishin udhëhequr këtë kryengritje, edhe më tutje do të mbesin në Shqipëri dhe do të hartojnë plane të tjera për kryengritje kundër pushtuesve serbë dhe malazias.

---

<sup>1578</sup> Shih: Poincare, Raymond: *“Lufta e Parë dhe e Dytë Ballkanike si dhe Konferenca e Londrës 1912-1913”*, Shkup-Tiranë-Prishtinë 2009, faqe 472-476.

## REZISTENCA E ARMATOSUR KUNDËR PUSHTIMIT DHE RIPUSHTIMEVE

Pushtimi i Kosovës (me këtë kuptohet edhe pjesët shqiptare në Maqedoni nga Shkupi, Tetova, Dibra e deri në Manastir) nga ana e ushtrisë së Malit të Zi dhe asaj të Serbisë në dhjetor 1912 si dhe pushtimi i pjesëve të Shqipërisë së Jugut nga Greqia (Janina dhe Çamëria), ishin pjesë e marrëveshjeve midis shteteve sllavo-ortodokse të Ballkanit gjatë aleancave të tyre për ta shuar përfundimisht çështjen shqiptare me anën e pushtimeve dhe pastaj të copëtimit të hapësirës së tyre etnike. Edhe pse kjo politikisht dukej e pamundur - meqë, si dihet, Shqiptarët dhe Shqipëria, për një pjesë të fuqive të mëdha europiane (Austro-Hungarinë dhe Italinë, por edhe për Britaninë e Madhe) ishin kthyer në një faktor me të cilin llogaritej të ndalej hegjemonizmi sllavo-ortodoks në Ballkan e me të edhe zgjerimi i sferës së ndikimit të Rusisë në këtë pjesë tejet strategjike – megjithatë, shtetet ballkanike kërkonin që me anën e luftës ta sillnin politikën para akteve të kryera, të cilat doemos se duhej të përfillëshin, në mos në tërësi, atëherë që Shqiptarët dhe hapësira e tyre të ktheheshin në gonetë kusuritjetje, në mënyrë që me kohë, si çështje ta humbte rëndësinë, ose të shuhej fare.

Kështu, krahas shfrytëzimit të luftës me forcat osmane nëpër vijat e para të fronteve, pra të atyre që paraqiteshin si kufij midis shteteve ballkanike (Serbisë, Malit të Zi, Bullgarisë dhe Greqisë) për të depërtuar drejt pjesëve që “duhej çliruar nga pushtimi osman”, ushtritë e këtyre vendeve kishin udhëzime të hollësishme si duhej vepruar që të shkatërrohej etnia shqiptare sa më shumë që të ishte e mundur. Meqë, ishte fare e natyrshme që Shqiptarët, t’u rezistonin ushtrive pushtuese, por edhe t’i pengonin që të ushtronin terror ndaj popullatës së pambrojtur, ushtritë pushtuese duhej të vepronin pa mëshirë dhe këtë ta bënin nën pretekstet e “rezistencës së armatosur proturke”.<sup>1579</sup> Madje, në përputhje me këtë qëllim, komandat ushtarake, me vete kishin dhe “njësitë e veçanta”, të cilat duhej të merreshin me “gjenocidin selektiv” ndaj popullatës shqiptare. Këtë e nxjerr në dritë edhe një pjesë e shtypit serb të kohës, duke cituar gazetën “*Reich Post*”, me ç’rast bëhet e ditur për vrasjen e mbi 2.500 Shqiptarëve në pjesën e Gjakovës dhe të rrethinës.<sup>1580</sup>

---

<sup>1579</sup> Shih urdhrin e Divizionit I të Shumadisë drejtuar njësisve operative në pjesën e Prizrenit në “*Prvi Balkanski rat 1912-1913*”, libri II, faqe 261; Hrabak, Bogumil: “*Albaski ustanak 1912 godine*”, faqe 207.

<sup>1580</sup> “*Srbske Novine*”, më 10.01.1913.

Për këtë masakër dhe të tjerat që ndërmerreshin ato ditë njofton edhe “Tajms”, e cila bën të ditur se në qytetin e Gjakovës ushtria dhe organet e pushtetit kishin pushkatuar 300 njerëz.<sup>1581</sup>

Njoftime të ngjashme alarmante do të vinë dhe nga krahina e Lumës, ku ushtria serbe masakroi me qindra banorë të kësaj pjese edhe pasi që një pjesë e Shqiptarëve kishin dorëzuar armët. Bëhet fjalë për pushkatimin mizor të mbi 500 vetëve dhe për keqtrajtimin e familjeve të tyre, të cilat kishin qenë të detyruara të merrnin arratinë drejt viseve malore.<sup>1582</sup>

Në këto rrethana kemi shfaqjen e organeve të para administrative, të cilat do të krijohen nga ana e pushtuesit. Ato fillojnë të vendosen ashtu si funksiononin në Serbi, në qarqe, rrethe dhe komuna në muajt e parë të vitit 1913 në përputhje me vendimin nr. 18714 të 5 nëntorit 1912.<sup>1583</sup>

Natyrisht se këto urdhëresa dhe dekrete, siç ishte ai “*Mbi rregullimin e krahinave të çliruara*”, mbështeteshin në “*Ligjin mbi bashkimin e Serbisë së Vjetër, Mbretërisë Serbe dhe qeverisjes së saj*”.<sup>1584</sup>

Në përputhje me këto ligje u bënë dy veprime të shpejta: ai për çarmatosjen e popullatës si dhe për regjistrimin e popullsisë nga ana e organeve ushtarake në Kosovë dhe në Maqedoni,<sup>1585</sup> veprime këto me pasoja të kobshme për Shqiptarët.

Çarmatimi i popullsisë shqiptare, që bëhej me pretekst se armët e fshehura do të përdroreshin “kur të dushkojë mali”,<sup>1586</sup> ishte pjesë e terrorit të organizuar shtetëror ndaj shqiptarëve. Bëhej me mjete ushtarake dhe arsye tohej me “masat për normalizimin e jetës” dhe “eliminimin e faktorëve që këtë e pengonin”. Organet ushtarake serbe përdornin metoda brutale, jo vetëm duke demonstruar forcën, por duke përdorur metoda të poshtërimit dhe të fyerjes së dinjitetit njerëzor, pas të cilave Shqiptarët do të detyroheshin të rrokin armët për të kërkuar hakmarrje, ose për t’u shpërngulur në drejtim të Turqisë, apo për t’u zhvendosur në drejtim të Shqipërisë. Kur ndodhte veprimi i parë, atëherë pasonin fushatat ushtarake të përmasave të gjera. Rrethoheshin katundet dhe pjesët përreth, të cilat “pastroheshin nga kryengritësit shqiptarë”. Në katundin Nishor të Suharekës, më 19 shkurt 1913, me arsyetimin se “kërkoheshin kryengritësit”, ishin vrarë që të gjithë meshkujt e moshës madhore,

<sup>1581</sup> Rushiti, Limon: “*Lëvizja Kaçake në Kosovë 1918-1928*”, Prishtinë, 1981, faqe 11.

<sup>1582</sup> “*Radničke Novine*”, Beograd, 22. II. 1913.

<sup>1583</sup> Rushiti, Limon: “*Lëvizja kaçake në Kosovë 1918-1928*”, Prishtinë, 1981, faqe 13.

<sup>1584</sup> Guzina, Ružica: “*Opština u Srbiji 1839-1918*”, Beograd, 1976, faqe 447.

<sup>1585</sup> Po aty, faqe 447.

<sup>1586</sup> “*Arkivi i Institutit Historik Ushtarak të Beogradit*”, raport i Shtabit Gjeneral, kutia-53, faqe 2, nr. 2/23 dhe Rushiti, Limon: “*Lëvizja Kaçake në Kosovë 1918-1928*”, Prishtinë, 1981, faqe 12.

42 vetë. Ishin pushkatuar sy fëmijëve dhe grave, pastaj “si ndëshkim” pse, si thuhej, ishte plagosur një ushtarë serb, edhe pse fshatarët thoshin se kush prej tyre nuk kishte shkrepur në drejtim të ushtarëve, e gjithë pasuria u ishte plaçkitur. Me këtë katundi Nishor, që kishte rreth 60 shtëpi ishte rrafshuar me tokë.<sup>1587</sup>

Me të njëjtat pretekste dhe në të njëjtën mënyrë ishte vepruar edhe në Kabash të Prizrenit kur ushtria serbe nga 19 marsi deri më 1 prilli 1913 kishte vrarë 17 veta, në Korishë 8, në Lubizhdë 1 dhe në Lutogllavë 1 person.<sup>1588</sup> Burimet vendore bëjnë të ditur për dy herë më shumë të vrarë.<sup>1589</sup>

Edhe urdhri për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë ishte pjesë e këtij skenari, meqë ai bëhej nga ana e organeve ushtarake në Kosovë dhe në Maqedoni dhe përcillej me metoda ushtarake, ku nuk mungonte dhuna. Regjistrimi i popullatës së përgjithshme nuk kishte gjithaq karakter civil, sa ushtarak dhe strategjik për Serbinë, meqë me mbledhjen e të dhënave rreth popullsisë së pranishme, regjimi ushtarak dhe ai civil, njëherësh krijonte “alibi” për dy veprime antishqiptare: në njërin anë, që të shpallte “armiq” gjithë ata që për arsye të terrorit ishin fshehur, dhe këtë tashmë mund ta bënte në përputhje me ligjin “mbi kapjen dhe likuidimin e hajdutëve”, dhe në tjetrën anë të ndalonte kthimin e të zhvendosurve ose të shpërngulurve në pjesët e tjera sipas marrëveshjes së paqes që do ta lidhë me Perandorinë Osmane në prill të vitit 1913, me ç’rast, formalisht, Beogradi zotohej se kjo do t’u lejohej gjithë atyre që ktheheshin deri më 1 prill 1915.<sup>1590</sup>

Me këtë dekret, sipas të cilit “hajdutë” mund të shpallehin mbi pesë persona të cilët tuboheshin në mbrëmje në një vend, regjimi ushtarak filloi të ndërhynte në ndejat e rëndomta të njerëzve nëpër katunde ose edhe në festat e tyre. Në bazë të këtij ligji organet ushtarake kishin të drejtë të vritnin pa vendim gjyqi. Mjaf-tonte të thuhej se fjala ishte për “hajdutë”, ose “armiq” dhe çështja mbyllej.<sup>1591</sup>

Në përputhje me këtë praktikë, e cila kishte marrë përmasa shqetësuese, na-çellniku i Qarkut të Kosovës me aktin nr. 7260 të 21 tetorit 1913, i shpalli për “hajdutë” të gjithë Shqiptarët që nuk gjendeshin në shtëpitë e veta dhe që nuk i paraqiteshin pushtetit. I njëjti, për t’ia çrregulluar çdo “normalitet” jetës së Shqiptarëve edhe aty ku bëheshin përpjekje që të ruhej me durimin e fundit, propozon shpërnguljen e familjeve “kryengritëse” në katundet serbe të rrethit të Mitrovicës,

---

<sup>1587</sup> “Arkivi i Institutit Ushtarak të Beogradit”, kutia 53, faqe 2, nr. 2/23.

<sup>1588</sup> Po aty.

<sup>1589</sup> Rushiti, Limon: “Lëvizja Kaçake në Kosovë 1918-1929”, Prishtinë, 1981, faqe 12.

<sup>1590</sup> Guzina, Ružica: „Opština u Srbiji 1839-1918“, Beograd, 1976, faqe 448, dhe „Uredba o javnoj bezbednosti u oslobođenim oblastima“, Beograd, 1913.

<sup>1591</sup> Po aty.

ndërsa në shtëpitë e tyre të vendoseshin Serbët e sjellë nga katundet serbe, me ç'rast ata do të gëzonin të drejta që të posedonin tokë pa kufizim, me kusht që të jenë në gjendje që ta punonin.<sup>1592</sup>

Përkundër këtyre masave drastike të pushtetit okupues serb dhe malazias, të cilat vazhduan gjatë gjithë kohës sa zgjati Konferenca e Ambasadorëve në Londër, por që do të intensifikohen pas mbarimit të saj kur Serbisë do t'i përlligjet pushtimi i Kosovës (bashkë me viset shqiptare në Maqedoni), pos pushtimit klasik ushtarak, Serbia e as Mali i Zi nuk do të jenë në gjendje që të vejnë në veprim ndonjë pushtet civil në viset e pushtuara. Përkundrazi, emërimi i naçellnikëve nëpër rrethe, rëndom ishte një farsë e pushtetit ushtarak, i cili nxitonte të kryente detyra në mënyrë që Komisionin Ndërkombëtar të Kufijve, të caktuar nga Konferenca e Londrës ta sillte para akteve të kryera, pra që të përcaktonte kufirin pikërisht sipas kërkesave serbe dhe malazias, por edhe greke në Jug, në dobi të këtyre vendeve.

Në këtë kohë kemi lëvizjen e gjerë të rezistencës ndaj vendosjes së çfarëdo pushteti serb, me veprime individuale, por edhe me formimin e çetave në pjesë të ndryshme, edhe pse fjala është për qëndresë pa ndonjë lidhje të brendshme dhe qendër drejtuese, ngase pjesa më e madhe e liderëve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, që kishin organizuar mbrojtjen gjatë luftës pushtuese të vendeve fqinje kundër Perandorisë Osmane, ndodheshin në internim në Serbi apo të shkëputur jashtë vendit. Edhe si e tillë qëndresa ia vështirësoi planet pushtuesit që të instalonte administratën civile dhe me këtë të krijonte kushtet për kolonizimin e shpejtë të Kosovës.

Krahas faktorit të brendshëm vendosjen e administratës pushtuese si dhe krijimin e rrethanave për kolonizimin e viseve të pushtuara shqiptare në Kosovë dhe Pollog, do ta pengojnë edhe raportet në ashpërsim e sipër të Beogradit me Austro-Hungarinë, në prag të Luftës së Parë Botërore, të cilat po acaroheshin nga shkaku i gjendjes në Bosnje dhe Hercegovinë, ku Serbia kishte vënë në veprim Serbët e atjeshëm për ta destabilizuar këtë vend në përputhje me qëndrimin tashmë të njohur se ata duhej të bashkoheshin me Serbinë.

Natyrisht se në këto rrethana të turbullta kur bota ndodhej para një krize të re, e cila për pasojë kishte vendimet e padrejta të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, që ndonëse kishte plotësuar një pjesë të madhe të kërkesave të vendeve sllavo-ortodokse (aleatëve të Rusisë), kishte lënë të kurdisur bombën e madhe

---

<sup>1592</sup> Po aty.

Bosnje dhe Hercegovinë, e cila priste të shpërthente. Beogradi do të tregohet i vëmendshëm që të mos i shkatërrojë të gjitha urat me pjesën e Fuqive të Mëdha, që i merrte për aleate, të cilat, po ashtu, kishin vendosur për një Shqipëri autonome gjysmake, por edhe nga shkak i reagimit të opinionit të tyre tepër kritik, nuk do ta miratonin që pjesa tjetër e Shqiptarëve të mbetur nën Serbi, Mal të Zi apo Greqi, t'i nënshtroheshin një zhdukjeje të pamëshirshme, siç e kishin paraparë këto vende.

Pas plasjes së Luftës së Parë Botërore, kur Austro-Hungaria do të hyjë në luftë me Serbinë, ndërkohë që këtë do ta bëjë edhe Gjermania, duke krijuar Boshnin, ndërsa në tjetrën anë Britania e Madhe, Franca dhe Rusia do të krijojnë bllokun e Antantës, pra i ndodhur përballë një gjendje tjetër fare, ku mund të ndryshojnë raportet, Beogradi jo vetëm fashiti trysinë ushtarake ndaj Shqiptarëve, por u vu në veprim që midis tyre të gjente edhe aleatë, midis feudalëve, me të cilët kishte lidhje të mira, ose duke emëruar këshilla të përbashkëta qeverisëse dhe administrative nëpër rrethe dhe qytete, ku paritë e dikurshme merrnin shumë nga kompetencat që kishin edhe gjatë kohës osmane.

Në këtë drejtim, Serbia ia doli që në konceptin e saj të kundërshtimit të pranisë së forcave austro-hungareze, të cilat u futën në Kosovë në vitin 1916, pasi që të kenë thyer ushtrinë serbe, e cila nëpër Shqipëri, kishte ikur për në Korfuz, të fusë edhe një pjesë të mirë të Lëvizjes Kaçake Shqiptare, ndër të cilët edhe Azem Bejtën dhe të tjerët, të cilët bashkë me çetnikët serbë luftuan praninë austro-hungareze në Kosovë, edhe pse ajo kishte larguar okupatorin serb dhe Shqiptarëve, në pjesën që mbikëqyrte, në bazë të një autonomie të brendshme, ua kishte kthyer shumë nga të drejtat kombëtare: administratën në gjuhën shqipe, shkollimin në gjuhën shqipe, të drejtën e pronave dhe të tjera.<sup>1593</sup>

Sidoqoftë, në shtator të vitit 1918, kur u pa se Bullgaria do të kapitulojë së shpejti (më 29 shtator u nënshkrua akti i kapitullimi), qeveria serbe, sërish iu kthye Shqiptarëve, kryesisht atyre me të cilët edhe më parë kishte pasur lidhje dhe kishte llogaritur se me anën e tyre do t'ia dilte që çështjen shqiptare ta instrumentalizonte për nevojat e veta në mënyrë që ta fitonte rolin e mbikëqyrësit të saj kryesor.

Esat Pashë Toptani, edhe këtë herë shfaqej i pashmangshëm. Meqë, ai me forcat e veta prej pesë mijë vetash, para dy vitesh, duke ikur nga Durrësi para forcave austro-hungareze, u ishte bashkuar forcave të Antantës, Serbia kishte nxituar,

---

<sup>1593</sup> Më gjerësisht shih: Abdyli, Tahir: "Hasan Prishtina", Prishtinë 2004, faqe; Rushiti, Limon: "Lëvizja kaçake në Kosovë 1918-1928", Prishtinë 1981, faqe 21, 22 dhe 205-217.

që muajve të fundit të marrë përsipër financimin e ushtrisë së Toptanit, që për Beogradin quhej “Ushtri aleate e shtetit shqiptar”.<sup>1594</sup>

Hesapi serb ishte i matur mirë. Sepse, me anën e përkrahjes së “ushtrisë shqiptare” të Toptanit jo vetëm që ruante të drejtën që të përcaktonte përfitimet e ardhshme në Shqipëri, por me këtë pengohej çfarëdo rezistence të mundshme të Shqiptarëve, që mund t’u bëhej forcave serbe sapo të futeshin në Kosovë dhe viset e tjera, pas atyre franceze. Nga një proklamata në gjuhën serbe dhe turqishte (me shkronja arabe) që i ishte shpërndarë popullatës në rrethin e Kumanovës, të Prishtinës, Lebanës, Kaçanikut, Mitrovicës dhe Jeni Pazarit, qeveria serbe ftonte Shqiptarët “për bashkëpunim kundër pushtuesve bullgarë dhe austro-hungarezë” dhe premonte se “do të bëhemi prapë miq të mirë”, duke bërë të ditur se “nga ju varet fati juaj”.<sup>1595</sup>

Meqë ishte ushtria franceze ajo që do të hyjë në Kosovë, ndërsa pas saj do të futen edhe njësitë e ushtrisë serbe, Qeveria serbe, megjithatë, kishte bërë të gjitha përgatitjet e duhura që të organizohet pushteti serb në qendrat më të mëdha administrative, në mënyrë që këtë herë, prania e ushtrisë franceze të shfrytëzohej për këtë qëllim. Pasi që ushtria franceze hyri në Kosovë në fund të shtatorit të vitit 1918, përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë nga gjysma e tetorit filloi emërimin e naçallnikëve. I pari u emërua ai i rrethit të Nerodimës, Marko Despotoviq dhe u caktuan kryetarët e komunave. Në të njëjtën kohë naçallnik për rrethin e Gjilanit u emërua Zhivko Popoviq. Në tetor u caktuan edhe njerëzit e pushtetit policor për rrethet Llap dhe Graçanicë. Pas organizimit – emërimit të udhëheqësve për pushtetin policor në Qarkun e Kosovës – fillon organizimi edhe për pushtetin në Qarkun e Zveçanit. Ngjashëm do të veprohet edhe në rrethin e Vuçitërnës dhe për atë të Drenicës. Në këtë të fundit, naçallnik do të emërohet pop Agjelko Neshiq nga Mitrovica, i njohur për dhunën që kishte ushtruar në këtë pjesë ushtria serbe.<sup>1596</sup>

Në Qarkun e Prizrenit dhe atë të Gjakovës gjendja shfaqej “më ndryshe”, meqë atje, pas kapitullimit të ushtrisë bullgare (më 29 shtator 1918) e deri më 7 tetor 1918 kur do të shfaqet ushtria franceze, e cila kishte hyrë nga rruga malore e Tetovës, për një javë pushtetin e kishte marrë paria e vendit e përbërë nga disa shqiptarë dhe serbë vendorë. Paria e përzier kishte marrë vendim që të mbaheshin të dy flamujt: ai shqiptar dhe ai serb. Ishte dhënë një urdhër për ndërprerjen e ar-

---

<sup>1594</sup> Po aty.

<sup>1595</sup> Hrabak, Bogumil – Janković, Dragoslav: „Srbija, 1918“, Beograd, 1968, faqe 180-181.

<sup>1596</sup> Rushiti, Limon: “Lëvizja Kaçake në Kosovë 1918-1929”, Prishtinë, 1981, faqe 24.

miqësive, ndërsa një që kishte ndodhur (vrasja e një Serbi nga një shqiptar të zënë në një kafe për “çështje politike”) kishte përfunduar me dënim me varje të Shqiptarit nga “trupit gjykues”, që ishte drejtuar nga një shqiptar. “Gjykatësi” shqiptar, që kishte shqiptuar dënimin për varjen e vrasësit të Serbit, kishte dalë me flamur shqiptar t’i priste ushtarët francezë dhe ata serbë, por me të shpejt e mori vesh se po kthehej pushtuesi i njëjtë, ai që para tri vitesh ishte dëbuar nga forcat austro-hungareze, të cilat tashmë kishin humbur luftën.<sup>1597</sup>

Organizimi i pushtetit edhe në Gjakovë, ishte bërë sipas “modelit” të parisë së Prizrenit. Një delegacion i parisë së Gjakovës i përbërë nga Shqiptarë dhe Serbë, kishte shkuar në Prizren te komandanti i trupave franceze, që të kërkojë ndihmë, në mënyrë që atje të mos u lejohej trupave të Malit të Zi të bënin organizimin e pushtetit, meqë ata kishin kryer shumë krime gjatë kohës sa kishin qëndruar aty. Bëhet e ditur se nga “paria” e Gjakovës ishte kërkuar që ata të propagandonin bashkimin me Mbretërinë e Serbisë nëse donin t’u hiqet qafe regjimi i Malit të Zi, gjë që kështu edhe kishte ndodhur. Madje, disa nga kjo pari kishin marrë për detyrë të mblidhnin nënshkrime me anën e të cilave duhej të “dëshmohej vullneti i Shqiptarëve për t’iu bashkuar Serbisë”.<sup>1598</sup> Këto nënshkrime, më vonë, të kurdisura sipas nevojës së vet, Beogradi do t’ia dërgojë edhe Konferencës së Paqes në Paris.<sup>1599</sup>

Pavarësisht këtyre veprimeve, me formimin e pushtetit të përmendur, si të përkohshëm, me ndihmën e ushtrisë franceze, ushtria serbe, sipas marrëveshjes me aleatët e vet, duhej të depërtonte menjëherë dhe të bënte vendosjen dhe shpërndarjen e trupave në gjithë vendin. Kështu, Komanda Supreme Serbe urdhëroi Divizionin e Timokut, të ripushtonte Kosovën. Ushtria serbe hyri në Kaçanik më 16 tetor 1918, në Ferizaj më 18 tetor dhe më 19 tetor në Lipjan. Një divizion tjetër, ai jugosllav, që ishte formuar në Frontin e Selanikut depërtoi në Prishtinë më 20 tetor, prej nga pastaj regjimentet e tij drejtohen për në Pejë dhe pjesët e tjera të Kosovës, të cilat brenda muajit tetor vunë nën mbikëqyrje të plotë në përputhje me planin e paraparë me forcat aleate.<sup>1600</sup>

Gjatë vendosjes së njësisë ushtarake bëhej edhe emërimi i bartësve të funksioneve të ndryshme të pushtetit okupues, i cili sillte me vete pjesën e aparatit, i cili edhe më parë kishte vepruar ose shërbyer në Kosovë nga viti 1913 e këndej.

---

<sup>1597</sup> Po aty, faqe 25.

<sup>1598</sup> Po aty, faqe 25.

<sup>1599</sup> Bajrami, Hakif: “*Si e riokupoi Serbia Kosovën më 1918*”, libri 2, Prishtinë 2012, faqe 86-110.

<sup>1600</sup> Rushiti, Limon: “*Lëvizja kaçake në Kosovë 1918-1928*”, Prishtinë 1981, faqe 26.



Fillimisht, Beogradi do t'i mbetet besnik edhe ndarjes territoriale në qarqe, rrethe dhe njësi të tjera sipas ndarjes së vitit 1913, duke e zgjeruar atë edhe në Has dhe në Lumë, pjesë këto që ushtria serbe i kishte pushtuar dhe i mbante nën mbikëqyrje të ashpër ushtarake. Kështu, Kosova ishte ndarë në tri qarqe: në atë të Kosovës, në qarkun e Zveçanit dhe në qarkun e Prizrenit.

*Qarku i Kosovës* kishte këto rrethe: Nerodimen (Ferizajn), Gjilanin, Graçanicën (Prishtinë) dhe atë të Llapit (Podujevën).

*Qarku i Zveçanit* kishte këto rrethe: Mitrovicën, Vuçitërnën dhe Drenicën (Deviqin).

*Qarku i Prizrenit* kishte këto rrethe: Sharrin (Prizreni), Gorën (Vranishtën), Podgorën (Suharekën), Rahovecin dhe Gjakovën.<sup>1601</sup>

Dy vjet më vonë, territori i Kosovës ishte ndarë në 5 qarqe:

I. *Qarku i Zveçanit* me seli në Mitrovicë me naçallnik M. Baniqin, kishte tri rrethe, 25 komuna me 302 vendbanime e 81.733 banorë. Në Qarkun e Zveçanit bënin pjesë këto rrethe: Mitrovica me 8 komuna, 130 vendbanime, me 16,107 banorë, e me naçallnik rrethi Karoqjiq. Në rrethin e Vuçitërnës me naçallnik Z. Mitiqin përfshiheshin 9 komuna me 97 vendbanime e 32.405 banorë. Rrethi i Drenicës (selia në Llaushë) me naçallnik L. Mariqin kishte 7 komuna me 75 vendbanime e 23.821 banorë.

II. *Qarku i Kosovës* me qendër në Prishtinë me naçallnik J. Krasojeviqin, përbëhej prej 55 komunave me 506 vendbanime, kishte 251.821 banorë.

III. *Qarku i Metohisë (Dukagjini)* me qendër në Pejë e naçallnik R. Vasileviqin kishte 21 komuna me 267 vendbanime e 92.156 banorë me këto rrethe: atë të Gjakovës me naçallnik M. Markoviqin, që kishte 7 komuna me 97 vendbanime e 27.800 banorë; të Istogut me naçallnik J. Samarxhiqin, kishte 6 komuna, 70 vendbanime e 18.947 banorë; rrethin e Pejës me naçallnik L. Protiqin, me 7 komuna, 99 vendbanime e 30.900 banorë.

IV. *Qarku i Prizrenit* me naçallnik S. Todoroviqin, kishte 75 komuna me 326 vendbanime e 114.402 banorë. Në këtë qark përfshiheshin këto rrethe: Gora (Vranishte) me naçallnik Zh. Jevtiqin, me 16 komuna, 52 vendbanime e 14.677 banorë; Luma (Bica) me naçallnik S. Dajiqin, me 10 komuna, 31 vendbanime e 10.349 banorë; Podgora (Suhareka) me naçallnik M. Parliqin, me 10 komuna, 35 vendbanime e 13.229 banorë; Podrimja (Rahoveci) me naçallnik M. Protiqin, me 15 komuna e me 100 vendbanime, me 25.026 banorë; Prizreni që formonte një

---

<sup>1601</sup> Hrabak, Bogumil: "Reokupacija Srbske i Crnogorske države arbanaskom većinom stanovništva u jesen 1918, i držanje Arbanasa prema uspostavljenj vlasti", në „Gjurmime Albanlogjike“, nr. 1 Prishtinë, 1969, f. 258.

komunë me 16.370 banorë; Hasi (Krumë) me naçallnik M. Stojanoviqin, me 7 komuna, 50 vendbanime e 12.033 banorë.

V. *Qarku i Shkupit*: në të cilin nga territori i Kosovës përfshiheshin rrethi i Kaçanikut me naçallnik J. Gjorgjeviqin, kishte 4 komuna me 38 vendbanime e 10.193 banorë.<sup>1602</sup>

Si shihet, territori i Kosovës ishte ndarë në pesë qarqe me 18 rrethe, 180 komuna, me 1 439 vendbanime e me 549.871 banorë. Këtu ishin të përfshira edhe dy rrethe: i Lumës dhe i Hasit, nën pushtimin e përkohshëm të Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene (SKS), me 17 komuna, 81 vendbanime e me një popullsi prej 22,382 banorë.

Kjo ndarje territoriale, nuk do të qëndrojë gjatë, meqë Mbretëria Serbe Kroate dhe Slllovene, e bashkuar në një shtet të ri të Sllavëve të Jugut pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, nën trysninë e hegjemonizmit serbomad, që kishte filluar të tregonte pretendimet se shteti i ri duhej të kthehej në një Serbi të Madhe, ndryshoi ndarjen administrative në përputhje me projektet e saj të njohura për serbizimin e viseve të pushtuara, veçmas atyre shqiptare, me anën e thyerjes së kompaktësisë së popujve të pjesëve që përbënin një etni. Këtyre ndryshimeve administrative shkas u dha edhe Kushtetuta e “Vidovdanit” e 18 qershorit 1921, e cila kishte paraparë ndarjen e re administrative të krahinave, në përputhje me synimet e borgjezisë serbe.<sup>1603</sup>

Sipas dekretligjit të 22 prillit 1922, territori i Kosovës u nda në mes këtyre krahinave:

1. Krahina e Kosovës me qendër në Prishtinë, që përfshinte këto qarqe të ndarjes së mëparshme: qarkun e Kosovës pa rrethin e Gjilanit, qarkun e Prizrenit me të gjitha rrethet – pa Lumën dhe Hasin (territore të Shqipërisë), rrethin e Vuçitërnës, kurse nga territoret jashtë Kosovës iu bashkuan qarku i Toplicës dhe i Jaballanicës, që ishin pjesë e qarkut të Vranjës.

2. Krahina e Vranjës nga territori i Kosovës përfshinte rrethin e Gjilanit.

3. Krahina e Rashës, me qendër në Çaçak, nga territori i Kosovës, përfshinte rrethin e Zveçanit.

4. Krahina e Zetës, me qendër në Cetinë, përfshinte nga territori i Kosovës Qarkun e Dukagjinit me të gjitha rrethet që e përbënin para kësaj ndarje.

5. Krahina e Shkupit përfshinte nga territori i Kosovës rrethin e Kaçanikut.<sup>1604</sup>

<sup>1602</sup>Allmanah Kraljevine SHS, (Pjesa e parë) 1921-22, Beograd 1922, faqe 123-126.

<sup>1603</sup>Čukinović, Ferdo: „Jugoslavija između dva rata“, Zagreb, 1961, faqe 371.

<sup>1604</sup>“Službene Novine”, nr. 92, 28 prill 1922.

Kjo ndarje territoriale dhe administrative ngeli deri më 6 janar 1929, kur shpallet Diktatura e 6 janarit dhe Mbretëria SKS.

Kjo ndarje administrative, e cila mbeti në fuqi për shtatë vjet, kishte për qëllim që hapësirën etnike shqiptare ta ndajë midis Serbisë dhe Malit të Zi në përputhje me paktin Serbi-Mali i Zi, të lidhur në prag të Luftërave Ballkanike si dhe shemave pushtuese që ishin lidhur midis këtyre shteteve për të ndarë etninë shqiptare. Dukagjinin do ta merrte Mali i Zi, ndërsa pjesën tjetër të Kosovës bashkë me Maqedoninë e merrte Serbia.

Ndonëse Mbretëria Serbe-Kroate-Sllovene e krijuar pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore kishte gëlltitur Malin e Zi bashkë me identitetin e tij shtetëror dhe kishtar duke e kthyer atë në “çështje të brendshme serbe”, megjithatë, qarqet shoviniste të Beogradit dhe Cetinës kishin ruajtur ujdinë e arritur që më parë, në mënyrë që etnia shqiptare e Kosovës të ndahej në dy pjesë, gjë që ishte në përputhje me planet për rrënimin e bërthamës së saj.

Kështu, Dukagjini, duke iu bashkuar krahinës së Zetës, shkëputej në tërësi nga lidhjet shoqërore, ekonomik dhe politike me pjesën tjetër të Kosovës, e cila po ashtu ishte ndarë në tri pjesë të tjera. Qarkut të Prishtinës i ishin marrë komunat shqiptare të Gjilanit dhe të Prizrenit dhe i ishin bashkangjitur disa pjesë të qarkut të Toplicës, pjesë këto të banuara me Serbë, që lidheshin ekonomikisht me Nishin dhe pjesët e tjera të Serbisë Lindore. Ngjashëm vlente edhe për Gjilanin që i ishte bashkangjitur krahinës së Vranjës, siç vlente edhe për rrethin e Zveçanit (me Mitrovicën, Vuçitërnën dhe Drenicën), të cilat i bashkoheshin krahinës së Rashës, me qendër në Çaçak. Meqë Shkupi, që më parë ishte ndarë në një krahinë të veçantë ku përfshiheshin qytetet e Pollugut Tetova, Dibra, Gostivari deri në Manastir, edhe më tutje mbante rrethin e Kaçanikut.

Kjo ndarje administrative paraqiste skenarin më të përshtatshëm që me anën e metodave administrative, ekonomike dhe politike për ta rrënuar etninë shqiptare të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare që kishin mbetur nën pushtimin e Beogradit. Krahas shkapërderdhjes administrative, ekonomike dhe politike të Shqiptarëve në tri drejtime (kah Mali i Zi, Serbia Qendrore dhe Serbia Jugore), e cila edhe teknikisht ishte e papërballueshme për këtë popullatë (mungonte infrastruktura rrugore që Kosovën e lidhte me këto qendra), regjimi i Beogradit kishte përgatitur terrenin si dhe infrastrukturën në njërën anë për sjelljen e kolonëve në tokat shqiptare, që do të bëhet me ligjet e njohura për kolonizim dhe për Reformën Agrare dhe në tjetrën anë për krijimin e rrethanave për shpërnguljen e Shqip-

tarëve drejt Turqisë dhe vendeve të tjera në përputhje me konventat që do të nënshkruhen me Turqinë për “riatdhesimin e popullatës myslimane”.

Në vitin 1929, pas shpalljes së diktaturës së Vidovdanit, kemi ndarje të re territoriale-administrative të Mbretërisë Jugosllave në 9 banovina (krahina). Territoret e pushtuara shqiptare të Kosovës dhe të Maqedonia u përfshinë në Banovinën e Moravës, të Zetës dhe të Vardarit. Në Banovina e Vardarit u përfshi qarku i Shkupit dhe i Manstirit. Ndërsa në atë të Zetës u përfshi pjesa e Dukagjinit me rrethet (Pejë, Mitrovicë). Në Banovinën e Moravës u përfshinë qarku i Graçanicës (me Prishtinën dhe Podujevën) si dhe Gjilani me Preshevën të lidhura me rrethin e Vranjës.

Në përputhje me këtë ndarje administrative si dhe me qëllimet që duhej ndjekur me anën e saj, ishte edhe ndarja ushtarake territoriale e Kosovës. Pas luftërave pushtuese të vitit 1912, në Kosovë u vendos Armata II me qendër në Shkup. Kjo zgjati deri në vitin 1915. Më 19 gusht 1919, me dekretin e regjentit A. Karagjorgjeviq, në emër të mbretit Petri I, e me propozimin e Ministrisë së Ushtrisë, u nxor dekretligji mbi ndarjen territoriale ushtarake, Mbretëria SKS ndahej në katër zona ushtarake, 15 divizione të krahinave, 45 regjimente të qarqeve dhe 180 batalione të rretheve.<sup>1605</sup>

Kosova u përfshi në Komandën e Armatës III në Shkup në kudër të Divizionit të Kosovës. Ndërsa, Divizioni i Kosovës, me qendër në Prishtinë, u nda në tri qarqe divizioni: Qarku i Regjimentit të Prizrenit, Qarku i Regjimentit të Prishtinës dhe Qarku i Regjimentit të Novi Pazarit.

Qarku i Regjimentit të Novi Pazarit ushtarakisht lidhte Mitrovicën, Vuçitërnën, Drenicën, Istogun dhe Pejën me Novi Pazarin, Sjenicën, Tutinin dhe pjesët e tjera të Sanxhakut. Edhe nga kjo pikëpamje pjesët veriperëndimore të Kosovës shkëputeshin nga qendra dhe lidheshin me ato të Sanxhakut, të cilat, si do të shihet, me rastin e ligjit për çarmatosjen dhe atij për “hajdutët”, do t’i ekspozohen një terrori të egër ushtarak, i cili do të përshejtojë që një pjesë e mirë e këtyre trevave të deklarohet si “myslimane” në mënyrë që ta fitojë të drejtën “për riatdhesim” në Turqi e me këtë edhe të shpërngulet atje.

Pjesa tjetër, që nuk do t’i nënshtrohet “riatdhesimit”, do të gjendet në shënjestër të vazhdueshme të aksioneve ushtarake, që ndërmerreshin në këto anë me “pretekste” herë të kapjes së “hajdutëve”, herë të ndjekjes së “kaçakëve” (sado që kjo lëvizje ka qenë e pranishme në këto pjesë prej nga edhe ka vepruar), ku rëndom pësonte popullata e pambrojtur, së cilës “në emër të pastrimeve”, i rrëno-

---

<sup>1605</sup> Rushiti, Limon: “Lëvizja Kaçake në Kosovë 1918-1928”, Prishtinë, 1981, faqe 30.

heshin pronat, shtëpitë dhe qenia e gjithëmbarshme ekzistenciale që për pasojë kishte shpërnguljen e dhunshme.

## LËVIZJA KAÇAKE DHE KOMITETI “MBROJTJA KOMBËTARE E KOSOVËS”

Lëvizja kaçake është forma e parë dhe më e dalluar e rezistencës kombëtare shqiptare ndaj forcave pushtuese serbe dhe malaziasë, të cilat u futën në tokat shqiptare gjatë Luftërave Ballkanike për të vazhduar pastaj edhe kundër atyre austro-hungareze dhe bullgare, në mënyrë që të ndërlihen me këtë veprimtari edhe pas rikthimit të pushtuesit serb në mbarim të Luftës së Parë Botërore, në vjeshtën e vitit 1918, për të vazhduar kështu me intensitete të ndryshme edhe për disa vite, përderisa do të nënshkruhet konventa shtetërore midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë në vitin 1926, kur kjo veprimtari, me ndonjë përjashtim, do të shuhet fare.

Kjo Lëvizje, megjithatë, deri te shfaqja e Komitetit “*Mbrojtja Kombëtare e Kosovës*”, të shumtën do të jetë pa ndonjë lidhje të brendshme e as pa ndonjë qendër drejtuese, që do ta lidhte veprimtarinë e vet me qëllime të caktuara politike, në përputhje me zhvillimet ndërkombëtare dhe veçmas me ato që kishin të bënin me fatin e mëtutjeshëm të Shqiptarëve në rrethanat e reja kur do të çrregulloheshin raportet e forcës të shumtën në dëm të tyre. Kjo ishte edhe e kuptueshme, meqë ajo mbështetej mbi një qëndrim atdhedashurie të faktorëve patriarkalë (feudalëve vendorë, fiseve dhe të bajraqeve), të cilët ishin të gatshëm për ta mbrojtur vatanin me çdo çmim. Por kjo nuk mjaftonte në ato rrethana kur kishin përballë pushtues me ushtri dhe polici të organizuar, me shtete që kishin pasdiploMACI dhe institucione të përgatitura që më parë për gjithfarë veprimesh dhe manovrimesh.

Mospërgatitja që të sillet në përputhje me rrethanat tepër të ndërlikuara dhe madje tragjike nëpër të cilën kalonte pjesa më e madhe e popullit shqiptar, do t’ia vështirësojë edhe më gjendjen lëvizjes së rezistencës që buronte nga kjo shtresë patriarkale që i besonte shtetit të përbashkët si të vetmit shpëtim, kur pas Konferencës së Paqes në Paris, Shqipëria si shtet, do të pranohet në përputhje me vendimet që kishte sjellë Konferenca e Ambasadorëve e Londrës në vitin 1913. Me atë rast, pas pranimit të saj në Lidhjen e Kombeve (1921), ajo merrte përsipër që të pranonte dhe të ratifikonte kufijtë me Jugosllavinë, pa marrë parasysh se

viset e shkëputura prej saj (Kosova dhe ato të Maqedonisë) do t'i njihen shtetit të ri, Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene (SKS).

Në këto rrethana, interesi shtetëror e obligonte Shqipërinë që t'i ndërpriste çfarëdo ndihme lëvizjes kaçake tutje kufirit, siç merrte përsipër edhe shuarjen e Lëvizjes Irredentiste brenda Shqipërisë, e cila ishte e fortë dhe shumë aktive në zhvillimet e brendshme nga Kongresi i Lushnjës e këndej për të shkuar edhe deri te viti 1924, kur në pamundësi të vepronte jashtë kufijve shtetërorë, veçmas në Kosovë ku tashmë Mbretëria Serbe-Kroate-Slllovene me të madhe kishte filluar procesin e shkombëtarizimit të viseve të pushtuara me anën e kolonizimit, reformës agrare dhe masave të tjera administrative dhe politike, do të implikohet në skenën e brendshme politike shqiptare, me pasoja fatale. Kjo do të çojë edhe të fundi i saj tragjik ndërkohë që raportet shqiptare do t'i ngarkojë me anatemën e një përçarjeje, që herë më pak e herë më shumë, do t'i ushqejë ndarjet, që do t'ua hapin rrugën edhe dallimeve të ndryshme shoqërore dhe politike madje, të cilat do të kthehen në realitete, të cilat nuk do të jenë në gjendje t'i zbusin as intermexot “e bashkimeve“, siç ishin gjatë Luftës së Parë Botërore dhe ato nga fillimi e deri në fund të Luftës së Dytë Botërore.

Sidoqoftë, rezistenca kombëtare kundër pushtuesve të rinj, do të shfaqet që nga koha kur ushtritë serbe, malaziase, greke dhe bullgare u futen në trojet shqiptare dhe secila për vete filloi të vendosë pushtetin e vet okupues me pretendime që ai të bëhet i përhershëm. Është e njohur kryengritja e Dibrës e vitit 1913, që do të përfshijë edhe një pjesë të mirë të viseve verilindore, e cila do të shuhet me gjak dhe për pasojë do të ketë depërtimin e mëtejshëm të ushtrisë pushtuese serbe në brendi të Shqipërisë. Po ashtu, janë të njohura edhe veprimet e disa grupeve të armatosura në pjesën e Dukagjinit, atë të Drenicës dhe të Karadakut kundër vendosjes së organeve të para policore-ushtarake nga gjysma e dytë e vitit 1913 e në vazhdim, të cilat do të shpeshohen edhe pas vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, kur do të mësohet se Kosova dhe gjysma e etnisë shqiptare mbetej nën sundimin e vendeve fqinje e pushtuar gjatë luftës së fundit.<sup>1606</sup>

Megjithatë, pas Konferencës së Ambasadorëve në Londër e deri sa filloi Lufta e Parë Botërore, më shumë mund të flitet për provokime të qëllimshme të ushtrive pushtuese ndaj popullatës së pambrojtur se sa për ndonjë lëvizje të organizuar, siç do të shfaqet pak më vonë. Ndër këto masa gjithsesi janë të njohura

---

<sup>1606</sup> Shih “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëll. III, Tiranë 2007, faqe 461-469.

dekreti për çarmatimin e popullatës shqiptare si dhe ligji për rekrutim, të cilit i parapriu ai i regjistrimit të popullatës nga organet ushtarake, që ishte i dhunshëm dhe i përcjellë me provokime të ndryshme ushtarake, pa përjashtuar ato që preknin dinjitetin e popullatës shqiptare.

Fillimi i Luftës së Parë Botërore dhe pas një viti edhe fillimi i humbjeve të Serbisë në luftë me forcat e Boshtit (atyre austro-hungareze dhe gjermane të cilave u ishte bashkuar Bullgaria e pak më vonë edhe Turqia), ndryshoi rrënjësisht gjendjen në Kosovë, meqë në njërin anë u shfaqën Austro-Hungarezët dhe Gjermanët, që i ndoqën pushtuesit serbë dhe malazias, duke ua njohur Shqiptarëve të drejtat kombëtare që nga vetëqeverisja, shkollimi në gjuhën amtare dhe veprimtaria e lirë ekonomike, të drejta këto që në vitin 1917 do të shkojnë edhe te pranimi i autonomisë shqiptare, ndërsa në tjetrën anë do të shfaqen Bullgarët, të cilët do të fillojnë, aty ku e kishin lënë pushtuesit serbë: me terror, dhunë, shkombëtarizim të mëtejshëm, pa përjashtuar këtu marrjen e meshkujve në punë të dhunshme për të ndërtuar rrugën Kërçovë-Manastir dhe mobilizimin po ashtu të dhunshëm të Shqiptarëve, të cilët do të dërgohen në frontet e ndryshme të luftës, ku shumë prej tyre do t'u humbin gjurmët përgjithmonë, gjë që bëri që energjia kryengritëse e deriatëhershme kundër pushtuesve serbë të drejtohej kundër tyre.<sup>1607</sup>

E ballafaquar me këto “realitete të dyfishta”, Lëvizja Kaçake si dhe në përgjithësi rezistenca e armatosur, ndodhej para sprovës që të shfaqej po ashtu me qëndrime të ndryshme, edhe pse fjala ishte për armiq të pushtuesit serb, të cilët në të vërtetë e kishin larguar atë, por silleshin në mënyra të ndryshme. Kjo vlente për Bullgarët dhe për pjesët që ata mbanin, që si do të shihet për nga zullumet nuk ishin shumë larg Serbëve. Andaj, ishte e arsyeshme që çetat e para kaçake të shfaqen në pjesën e Karadakut kundër pushtuesve bullgarë dhe terrorit të tyre. Aty shënohet veprimtaria e çetës së Iliaz Reçakut, ku përmenden edhe emrat e Jetish Behlulit, Rexhë Bardhit e të tjerë.<sup>1608</sup>

Meqë pjesa bullgare përfshinte një pjesë të mirë të Kosovës (pjesën lindore të Kosovës nga Prishtina e deri në Prizren, Shkup dhe Pollog), këtë gjendje do ta shfrytëzojnë Serbët për qëllime të veta, me ç'rast pushtuesit e deridjeshëm, të cilët kishin ushtruar aq shumë dhunë dhe terror ushtarak dhe policor kundër Shqiptarëve, pra ata që kishin qenë shkaktarët e njëjës ndër tragjedi më të madhe të kohës kundër një populli të tërë, shfaqeshin “miqësorë” dhe kërkonin “luftë të përbashkët dhe vëllazërore kundër pushtuesve gjermanë dhe bullgarë”.

<sup>1607</sup> Rushiti, Limon: “Lëvizja Kaçake në Kosovë 1918-1928”, Prishtinë, 1981, faqe 18.

<sup>1608</sup> Po aty, faqe 19.

Bëhet e ditur se për këtë qëllim, në janar 1917 komandanti i aradhes së Jabllanicës së Epërme, Milenko Vllahoviq duhet të jetë parë në Prishtinë në një takim me Bajram Govorin, të cilit i kishte premtuar ndihma materiale dhe me armë në luftë kundër Bullgarëve, me kusht që të bashkëvepronin mes vete. Ushtarakët serbë kishin depërtuar edhe nëpër pjesët e tjera të Kosovës, kur shfaqeshin grupet e vogla të kaçakëve shqiptarë për të lidhur marrëveshje me ta.<sup>1609</sup>

Takime dhe biseda të tilla kishte pasur edhe në pjesët serbe të pushtuara nga Bullgarët, si në Kurshumli dhe Prokupe, kur disa kaçakë shqiptarë kishin marrë pjesë në shumë biseda me ushtarakët serbë që drejtonin lëvizjen kundër Bullgarëve, prej nga kishte dalë qëndrimi që kaçakët shqiptarë, të ndihmuar me armë serbe dhe mjete të tjera, të çlironin Prishtinën, Mitrovicën dhe Pejën, ndërsa njësitë serbe do të vepronin në drejtim të Nishit. Madje, bëhet e ditur se në mars të vitit 1917 disa çeta kaçake shqiptare kishin marrë pjesë në një luftim në Kurshumli kundër Bullgarëve.<sup>1610</sup>

Kjo veprimtari, e cila do të vazhdojë deri me përfundimin e Luftës së Parë Botërore, megjithatë, një pjesë të mirë të kaçakëve të Kosovës tërthorazi e vende në pozitën e aleatit të fuqive të Antantës përkrah serbëve dhe malaziasve, njëherësh kundërshtarë kryesorë të Shqiptarëve. Kështu veproi asokohe edhe Esat Pashë Toptani, forcat e të cilit drejtpërdrejt ishin të përfshirë në anën e Antantës nga viti 1916 e deri në fund, duke marrë pjesë madje edhe në Frontin e Selanikut.

Kapitull i veçantë i këtij bashkëpunimi midis kaçakëve shqiptarë dhe lëvizjes serbe që drejtohej nga ushtarakë serbë, e ku rëndom ishin të përfshirë njësitë rezerve ushtarake të rezistencës, ishte ai i luftës kundër Austro-Hungarezëve, ani pse, si dihej ata kishin qenë të vetmit që kishin ndihmuar dhe përkrahur shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë. Dhe, po ashtu, kishin ndihmuar në Konferencën e Londrës që Shqipëria qoftë edhe si e përgjysmuar të pranohej shtet, e që pas fillimit të Luftës së Parë Botërore kishin qenë ata që kishin larguar pushtuesit serbë dhe malazias, pikërisht atë soldateskën vrastare që kishte masakruar popullatën shqiptare gjatë pushtimit të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare dhe kishte bërë që në sajë të asaj lufte pushtuese Shqipëria të mbetej gjysmake, ndërsa popullata e saj, në pjesët e pushtuara, të cilat Konferenca e Londrës do t'ia njohë Beogradit, t'i nënshtrohet pastrimit etnik me dhunë.

Edhe pse Austro-Hungarezët gjatë Luftës së Parë Botërore, në kuadër të planeve të tyre kundër shtetit serb dhe pretendimeve të tyre hegjemoniste në rajon,

<sup>1609</sup> Perović, Milivoje: “*Toplički Ustanak*“, Begorad, 1959, faqe 103-109.

<sup>1610</sup> Po aty, faqe 112-113.



Shqiptarëve ua kishin hequr pushtuesin dhe ua kishin kthyer të drejtat kombëtare nga shkollimi, administrata, vetëqeverisja e deri te autonomia që do të shpallet pak më vonë, një pjesë e kaçakëve shqiptarët, që vepronin në zonën e pushtuar nga Bullgarët, gjithnjë e më shumë do ta shtrijnë veprimtarinë e tyre në pjesët austro-hungareze, pra ku liderët shqiptarë nga Hasan Prishtina e të tjerë në vazhdimësi lëshonin thirrje që të krijoheshin aleanca me Austro-Hungarezët, Gjermanët dhe të luftonin kundër Serbisë e jo të bashkëpunohej me ta për qëllime të tyre.<sup>1611</sup>

Këtu, rol vendimtar do të luajë politika aktive e Serbisë, që Lëvizjen Kaçake të Shqiptarëve, e cila në pjesët e pushtuara nga Bullgarët haptas përkrahej prej tyre dhe thuajse në një pjesë të madhe drejtohej prej saj, ta venin në veprim në pjesën që e mbanin Austro-Hungarezët, në mënyrë që me këtë të arriheshin dy qëllime njëherësh: së pari që Lëvizja Kaçake të mos ketë një qendër drejtuese në përputhje me qëndrimet e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, dhe së dyti, që kaçakët shqiptarë duke luftuar kundër Austro-Hungarezëve të armiqësonin Shqiptarët me fuqitë e Boshtit dhe përkrahësit e tyre më të fuqishëm, të cilët, ishin të vetmit që Shqiptarëve dhe Shqipërisë u ofronin mbrojtje dhe garanci të mëtutjeshme. Beograd bashkë me të tjerët, jo vetëm që nuk garantonin gjë, jo vetëm që ata nuk i paraqitnin në anën e Antantës, por ata edhe më tutje bënë përpjekje që Shqiptarët t'i paraqitnin si armiq të përbetuar të forcave të Antantës dhe miq të fuqive të Boshtit, edhe pse kjo, sa i përket Kosovës, nuk përputhej me realitetin, ngaqë një pjesë e mirë e kaçakëve shqiptarë këtë e bënë nën mbikëqyrjen e Serbisë.

Ndikimi serb te disa grupe kaçake që operonin në zonën e Drenicës dhe atë të Kosovës Lindore, bazuar në të dhënat austro-hungareze, por edhe ato serbe, pa përjashtuar edhe raportet franceze, do të rritet edhe më nga pranvera e vitit 1918 e deri te shfaqja e ushtrisë franceze, në shtator të atij viti, kur ajo do të futet në Kosovë, e përcjellë nga repartet ushtarake serbe, që i shkonin pas që nga Fronti i Selanikut, të cilave do t'u dorëzohet Kosovës. Kaçakët shqiptarë do të ballafaqohen me një realitet tragjik, meqë rikthehej pushtimi serb tash edhe më i forcuar se më parë.

Ndonëse nuk mund të thuhet se kaçakët shqiptarë, të cilët me të drejtë kishin dalë në mal kundër pushtuesit bullgar këtë e bënë për të rikthyer pushtimin serb, por për të kundërtën, pra që ata të hiqnin qafe pushtimin e huaj, pa

---

<sup>1611</sup> Shih: HHStA – Haus-Hof-und Staatsarchiv, Politisches Archiv, Wien: Albanien: III-XXXVIII (1878-1918), dok. nr. 26/73; Abdyli, Tahir: “*Hasan Prishtina*”, Prishtinë 2004.

marrë parasysh se nga vinte. Megjithatë, me dëshirë apo pa të, në fund, shumë prej tyre, do të bien në grackën serbe, ku do të mbeten si humbës tragjike.

Në të vërtetë, kjo grackë kishte qenë e pashmangshme, kur Azem Bejta, qoftë pse deri atëherë nuk kishte pasur një qendër të përbashkët kombëtare, siç ishte ajo kur në Shkodër do të themelohet Komiteti “*Mbrojtja Kombëtare e Kosovës*” në tetor 1918 pasi që në Kosovë të ishin futur forcat franceze e bashkë me të edhe ato serbe, qoftë pse ishte gjendur në vorbullën e një lufte ku konfrontoheshin interesat e Fuqive të Mëdha, të cilat tashmë ishin në një luftë me njëra tjetrën dhe shfrytëzonin që të gjitha mjetet dhe mundësitë për t’i përdorur për vete faktorët e ndryshëm.

Një rol të madh këtu luanin edhe frontet e ndryshme të rezistencës dhe lëvizjet kaçake të tyre, pra i shkëputur dhe i rrethuar me pushtues, do t’u kthehet “fqinjëve”, siç ishte vepruar edhe gjatë fazës së fundit të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare kur një pjesë e feudalëve shqiptarë do të hyjnë në biseda dhe hesape me Serbinë dhe Malin e Zi, me premtimin “e ndihmës vëllazërore” dhe “të çlirimit të përbashkët”, pale se shpejt do të kuptojnë mashtrimin me pasoja të rënda për ta.<sup>1612</sup>

Me këso premtimesh kryeçetniku serb, Kosta Peçanac, kishte hyrë në bisedime edhe me Azem Bejtën, kaçakun më të njohur shqiptar, i cili ishte përfshirë në luftën kundër forcave të Boshtit. Ata ishin takuar në verën e vitit 1918 diku në katundin Pridvoricë të Kollashinit të Ibrit, në shtëpinë e Olimpie Bozhovqit. Ishte biseduar rreth “luftës së përbashkët” kundër “pushtuesve”. Bisedat vazhduan edhe në katundin Varage.<sup>1613</sup> Këto dhe veprime të ngjashme të kaçakut të Drenicës, që kishin filluar prej më shumë se një viti, nuk do të mbeteshin të pavërejtura dhe pa reagimin e Austro-Hungarezëve. Vjena e shpalli armik Azemin dhe kaçakët e tij, me të cilët hyri në disa luftime. Masat represive të austro-hungarezëve prekën edhe jatakët e tij në disa pjesë të Drenicës, me ç’rast, “për arsye sigurie”, disa prej tyre u depërtuan në Austri.<sup>1614</sup>

Armiqësia me Austro-Hungarezët dhe bashkëpunimi me çetnikët e Kosta Peçancit vazhdoi deri në fund në dobi të Serbëve. Kështu, nga fundi i luftës, kur një pjesë e forcave austro-hungareze ishin në tërheqje e sipër, te vendi i quajtur “Përroni i keq”, ranë në pritën e kaçakëve shqiptarë, me ç’rast do t’i dorëzohen Azem Bejtës, të bindur se do të lihen të lirë të tërhiqeshin, në përputhje me një

---

<sup>1612</sup> Po aty.

<sup>1613</sup> Perović, Milivoje: „*Toplički Ustanak*“, Beograd, 1956, faqe 356.

<sup>1614</sup> Rushiti, Limon: “*Lëvizja kaçake në Kosovë 1918-1928*”, Prishtinë 1981, faqe 57.

marrëveshje që ata kishin lidhur me disa nga liderët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në Shkodër, të cilët edhe më tutje Gjermano-Austriakët i shihnin si aleatët e vetëm, pa marrë parasysh fatet e luftës, që shkonin në dëm të tyre.<sup>1615</sup>

Por, robërit e zënë, bashkë me gjithë materialin tjetër luftarak, do t'i dorëzohen ushtrisë franceze, e cila, pasi që kishte marrë lajmin, kishte arritur në Mitrovicë dhe nga kaçakët shqiptarë i kishte marrë në dorëzim oficerët dhe ushtarët austro-hungarezë. Komandanti francez Balshe, me këtë rast, për nderë të Azem Bejtës dhe meritave të tij në luftë kundër Austro-Hungarezëve, kishte shtruar një darkë, ishte dekoruar me medalje për merita lufte dhe i ishte dhuruar një shpatë si trofe.<sup>1616</sup>

Kaçakët shqiptarë dhe liderët e tyre shpejt do të binden se “miqësisë” dhe “luftës së përbashkët çlirimtare” me Serbët i kishte ardhur fundi dhe se ajo po zëvendësohej me atë që tashmë ishte parë në këto anë në vjeshtën dhe dimrin e vitit 1912, kur ishin shfaqur ushtritë pushtuese malaziasë dhe serbe dhe kishin filluar terrorin e paparë ushtarak ndaj popullatës së pambrojtur.

Në të vërtetë, pasi që ushtria serbe të ketë marrë viset “e çliruara” nga ushtria franceze dhe të ketë vendosur administratën ushtarake-civile të njëjtë me atë që ishte thyer në vitin 1915 nga forcat austro-hungareze dhe gjermane, vazhdoi avazin e vjetër, por tash paksa më të maskuar, duke vënë në shënjestër ata që nuk i dorëzonin armët, pra kaçakët, të cilët deri më dje i kishin pasur përkrah kundër Bullgarëve, e më shumë kundër Austro-Hungarezëve. Ndërkohë joshite disa nga liderët vendorë nga radhët e parisë për bashkëpunim duke u dhënë ndonjë post sa për sy e faqe. Kryeçetniku Kosta Peçanac, i cili, nga Peja, ku kishte mobilizuar shumë luftëtarë të “maskuar” ishte nisur për në Shkodër, për “ta shpëtuar nga pushtimi italian”, do t'u dërgojë porosi kaçakëve shqiptarë “t'u ktheheshin fryteve të paqes”, në mënyrë “që t'i gëzonin bashkërisht ato”.

Meqë në Shkodër nuk do të rrinë gjatë, ngaqë pas presionit të Fuqive të Mëdha, të cilat pushtimin e Shkodrës nga Serbët e bënë çështje dhe asaj i dhanë ultimatum që ta lëshojë, Kosta Peçanci sërish kthehet në Kosovë. Por, në të kthyer nga Shkodra, nëpër Plavë e Guci dhe Rugovë e deri në Pejë, ushtri terror ndaj

---

<sup>1615</sup> Më gjerësisht rreth marrëveshjes së liderëve të Lëvizjes Kombëtare shqiptare në Shkodër me Komandën ushtarake austro-hungareze në këtë qytet në HHStA – Haus-Hof-und Staatsarchiv, Politisches Archiv, Wien: Albanien: III-XXXVIII (1878-1918), dok. nr. 26/73.

<sup>1616</sup> Rushiti, Limon: “Lëvizja Kaçake e Kosovës 1918-1928”, Prishtinë, 1981, faqe 22 dhe Osmani, Jusuf : “Kolonizimi, reforma agrare dhe shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova 1918-1941” III, Prishtinë, 2016 (Shih diskutimin e deputetit Fehrat Ali Draga në parlamentin jugosllav, ku ai flet për lidhjet e A. Bejtës me Kosta Peçancin dhe luftimet që kishte ai dhe kaçakët e tij kundër ushtrisë austrohungareze, faqe 71-77).

popullatës shqiptare, të cilën e detyronte që të merrte rrugët “e shpëtimit” drejt Shkodrës, pra që të zbrazej Kosova prej tyre. Kjo bëri që në rrethin e Pejës, (në Rugovë), në shkurt të vitit 1919 të shpërthejë një revoltë, por jo kryengritje, e cila me të shpejtë u shfrytëzua për një veprim ushtarak, që për pasojë pati djegien e vendbanimeve të shumta nga Rugova e deri në Plavë e Guci dhe vrasjen e 83 vetëve, ndërkohë që pjesa tjetër mori ikën për në Shkodër.<sup>1617</sup>

Për gjendjen e rëndë të shkaktuar pas ripushtimit të Kosovës nga forcat ushtarake serbe dhe veçmas nga njësitë çetnike të Kosta Peçancit, që operonin në zonën Pejë-Rugovë-Plavë-Guci duke i detyruar banorët e këtyre anëve të drejtoheshin kah Shkodra, pra pikërisht ato forca, të cilat deri dje kishin kërkuar nga kaçakët shqiptarë “që të luftonin vëllazërisht pushtuesin” (austro-gjerman), do të reagojë edhe Komiteti “Mbroja Kombëtare e Kosovës”, me një letër drejtuar kryetarit Villson (Uillson), duke kërkuar që të ndërhyjë sa më shpejtë që Beogradit të ndalë terrorin ushtarak. Në këtë letër bëhet e ditur se vetëm në Shkodër tashmë ndodheshin mbi pesë mijë refugjatë, të cilëve u kërcënohej vdekja nga uria.<sup>1618</sup>

Natyrisht se në këto rrethana, do të jetë edhe paria e popullatës së rrezikuar të Kosovës nga qendra të ndryshme, që do t’i drejtohen për ndihmë komandantit të Armatës III të Divizionit të Kosovës. Delegacioni i Prizrenit (prej pesë vetash), ai i Gjakovës dhe pjesëve të tjera kufitare do të paraqesin shumë dëshmi të vrasjeve, bastisjeve, burgosjeve dhe ndjekjeve që bëheshin nga xhandarët, të cilët, vepronin në emër “të kërkimit të bashkëpunëtorëve të Austro-Hungarisë”.

Shqetësuese për këtë popullatë, ishin dy masa të tjera: ajo e kërkimit të armëve, që përcillej me masa brutale dhe e mobilizimit për ushtri, që filloi në verën e vitit 1919, ku përfshiheshin dhunshëm të rinj të moshës 20-25 vjeçare. Për t’u ikur këtyre masave, shumë të rinj merrnin malet e të tjerë përpiqeshin të gjenin strehim në Shqipëri apo gjetiu. Kjo u jepte edhe më shumë “shkase” organeve policore dhe ushtarake të sapo vendosura për ndjekje masive të popullatës shqiptare. Në këto rrethana, disa prej tyre kërkonin t’u bashkoheshin çetave të kaçakëve.<sup>1619</sup>

---

<sup>1617</sup> Shih: “Populli i Plavës, Gusinjës dhe Rugovës muhaxhir në Shkodër”, botuar në gazetën “Populli”, 25.II.1919, cituar sipas Rushiti, Limon: “Lëvizja Kaçake në Kosovë 1918-1928”, Prishtinë, 1981, faqe 46.

<sup>1618</sup> Shih : AQSH, i RPSH, fondi, KMKK, dosje, 23/3, nr. 708705, 28. II. 1919, protesta ndaj veprimeve të qeverisë jugosllave ndaj shqiptarëve, dërguar kryetarit amerikan Wilson, dhe: “Tragjedia e Kosovës, Ç’vajtornjë gërmadhat e Rugovës”, botuar në gazetën “Kosova”.

<sup>1619</sup> Hrabak, Bogumil: “Jedan radikalski izveštaj o stanju na Kosovu 1921 godine”, në „Vjetari i Arkivit të Kosovës”, Prishtinë, IV-V (1968-169) dhe 1971, faqe 215, 217, 223.

Por, edhe pse çetat kaçake të Azem Bejtës dhe disa të tjera ia kishin arritur të mbijetonin këtë terror duke operuar nga Shqipëria në Kosovë dhe anasjelltas, atyre tashmë u ishte vështirësuar veprimi në masë të madhe nga se autoritetet ushtarake të Beogradit i kishin futur në indeksin e armiqve (po qe se nuk do t'i dorëzonin armët) si dhe kishin shtuar praninë e tyre edhe në pjesët e Drenicës dhe të Llapit, të cilat për një kohë kishin qenë të kursyera nga prania e tyre.

Megjithatë, në pranverën dhe verën e vitit 1919, në kohën kur në Paris vazhonte punimet Konferenca e Paqes dhe, pas raporteve për dhunë të shtuar ushtarake dhe policore ndaj popullatës së pambrojtur, vëmendja e faktorit ndërkom-bëtar ishte fokusuar te sjellja e autoriteteve shtetërore të Beogradit në Kosovë dhe pjesët e tjera të banuara me Shqiptarë, të cilat tashmë i ishin dhënë Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene, do të shënohen përpjekje të shtuara të organeve policore-ushtarake për të vu lidhje me kaçakët në mënyrë që ata të dorëzohen. Këto veprime bëheshin në pjesën e Drenicës dhe të Llapit dhe kishin të bënin me Sadik Ramën e Gjurgjevikut dhe Azem Bejtën, çetat e të cilëve herë pas herë vepronin në këto anë, me ç'rast raportohet se ata ia dilnin të zinin robër njësi të tëra xhandarësh, siç kishte ndodhur në komunën e Orllatit.<sup>1620</sup>

Bëhet e ditur se naçallniku i rrethit të Drenicës, në shtator të atij viti kishte thirrur në bisedime Azem Bejtën, siç ishte thirrur nga naçallniku i Podujevës, Ceroviq edhe Ramë Vllasa me shokë, të cilëve u ishin bërë oferta për t'i dorëzuar armët, me ç'rast atyre u ishin premtuar poste "çaushësh". Ceroviqi ishte takuar me Azem Bejtën në Zhabar të Mitrovicës, ku ishte biseduar edhe për çështje të tjera, por nuk ishte arritur ndonjë marrëveshje midis tyre.<sup>1621</sup>

Natyrisht se koha e "marrëveshjeve" të njëanshme që kishin shkuar në të mirë të Beogradit, siç ishin ato për "luftën e përbashkët kundër pushtuesit austro-hungarez", tashmë kishte kaluar, dhe se Serbët më së paku ishin të interesuar për to. Përkundrazi, ata kërkonin shkase për të vazhduar terrorin ndaj popullatës shqiptare, në mënyrë, që duke u fajësuar ajo pse edhe më tutje "ushqente lëvizjen kryengritëse" dhe "separatiste", të ndiqej vazhdimisht për t'u shpërngulur nga trojet e veta. Kjo tashmë ishte politikë zyrtare e Beogradit dhe për këtë qëllim përdorshin metoda të ndryshme, të cilat emërues të përbashkët kishin krijimin e rrethanave që Shqiptarët së pari të ndjeheshin ekonomikisht të pasigurt, pra të shpronësuar nga toka dhe prona tjetër private, pastaj të ndjeheshin të provokuar dhe në konflikt të vazhdueshëm me ligjin dhe pushtetin, qoftë kur të rinjtë e tyre

<sup>1620</sup> Rushiti, Limon: "Lëvizja Kaçake në Kosovë 1918-1928", Prishtinë, 1981, faqe 56.

<sup>1621</sup> Bajrami, Hakif: "Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë 1918-1941", Prishtinë, 1981, faqe 101

duhej të mobilizoheshin dhe kësaj i iknin, qoftë kur prej tyre kërkoheshin armë, qoftë kur vazhdonin lidhjet me lëvizjen kaçake, për ç'gjë secili mund të ndiqej dhe të akuzohej edhe pse dihej se në traditën e familjes shqiptare kushdo që kërkonte strehë e gjente. Me një fjalë, Shqiptarëve duhej t'u krijoheshin bindja se Kosova dhe viset e tjera shqiptare që kishin mbetur jashtë kufijve të Shqipërisë nuk ishin më shqiptare, por “tokë e shenjtë serbe”, e “vjedhur dhe e pushtuar prej tyre gjatë sundimit osman”, e cila i ishte kthyer “djepit të vet mesjetar”, që do të thoshte se për ta ajo ishte e huaj. Kjo e fundit, madje, bëhej me demonstrim ushtarak, por edhe me fushatën e madhe që ndërmerrete shteti që Kosova të fitonte “dukjen e shenjtërisë serbe”, duke ndërtuar manastire ortodokse në çdo lokalitet në mënyrë që Shqiptarët t'u nënshtroheshin rrethanave përlshëm, pra që të pranonin se gjendeshin “në tokat serbe”, ose të shpërnguleshin në Turqi.

Në këto rrethana, terrori shtetëror me mjete policore dhe ushtarake në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare që i kishin mbetur Beogradit, do të vazhdojë në emër të “kthimit të rendit dhe të ligjit” si dhe “luftimit të bandave kriminele” siç quheshin kaçakët, të cilët edhe më tutje vazhdonin veprimtarinë në pjesë të ndryshme të Kosovës, ndonëse të shkëputur dhe të shumtën me veprime hakmarrëse ndaj njërive policore dhe ushtarake që ushtronin terror, e ku në shënjestër gjendeshin edhe Shqiptarët që kishin filluar të përfshiheshin në aparatet shtetëror ose të emëroheshin prefektë, të cilët Beogradi rëndom i zgjidhte nga radhët e familjeve me të cilat kishte lidhje nga koha e Perandorisë Osmane. Disa nga këta Shqiptarë tashmë ishin përfshirë edhe në parinë e qyteteve dhe në disa këshilla të tjera bashkiakë, të cilët u paraqiteshin delegacioneve të huaja që vizitonin këto pjesë ose edhe diplomatëve, të cilët lëviznin nëpër këto anë për të parë gjendjen e vërtetë, gjithnjë duke u fokusuar “te mbrojtja e pakicave kombëtare” dhe “mbrojtja e të drejtave të tyre të besimit dhe të pronës”, që ishin në përputhje me Kartën e Lidhjes së Kombeve, ndërkohë që Beogradi ua paraqiste “një armik” i cili luftonte “për ta shkatërruar shtetin e sapoformuar të Sllavëve të Jugut dhe të njohur ndërkombëtarisht” në mënyrë që të bashkohej me një shtet tjetër - Shqipërinë.

Meqë në këtë kohë, pas pranimin të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve dhe detyrimeve që kishte ajo për të ratifikuar të gjitha marrëveshjet me vendet fqinje, në radhë të parë me Beogradin, Tirana kishte pranuar realitetin e Konferencës së Paqes të Parisit, pra ekzistencën e Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene si shtet në përbërje të të cilit tashmë ishte përfshirë edhe Kosova dhe viset e tjera shqiptare të pushtuara nga Beogradi dhe Podgorica gjatë Luftërave Ballkanike. Atëherë, rrënjësisht ndryshonte edhe gjendja e Lëvizjes Kaçake Shqiptare, ngaqë ajo tash-

më kishte dalë jashtë ligjit dhe ndiqej jo vetëm nga Beogradi, por ngjashëm duhej të ndodhte edhe në Shqipëri. Kështu, Shqipëria si shtet mund të shtronte vetëm çështjen e lirive dhe të drejtave të “pakicës” shqiptare jashtë kufijve, pra në përbërje të Mbretërisë SKS (edhe pse këtë e kishte të vështirë ta bënte për arsye formale meqë në Kosovë dhe pjesët e tjera Shqiptarët trajtoheshin “turq” dhe “myslimanë”), me çka përjashtoj çështja e bashkimit kombëtar, ose çështjet që mund të lidheshin me çlirimin eventual të Shqiptarëve nga Beogradi. Megjithatë këto ide vazhdonin të mbeteshin të fiksuara te Shqiptarët e Kosovës, e ku përfshiheshin edhe ata te Pollogut të Maqedonisë Perëndimore dhe lëvizja e tyre, e cila edhe më tutje nuk hiqte dorë nga shteti i përbashkët shqiptar.

Këtu dhe te kjo çështje Beogradi do të gjejë “atutë” e përhershme për të ushtruar terror shtetëror me mjete policore dhe ushtarake ndaj Shqiptarëve, gjithnjë duke u arsyetuar se Shqiptarët nuk pranojnë realitetet që ka vendosur Konferenca e Paqes dhe Lidhja e Kombeve, por veprojnë për të kundërtën, pra për ta shkatërruar atë, gjë që ata anatemoheshin si kundërshtarë të dyfishtë. Në këtë planimetri mund të thuhet se Lëvizja Kaçake dhe përcaktimi i saj që të mos pranohej pushtimi serb por ai të luftohej me të gjitha mjetet, pa marrë parasysh pasojat, mbetej “arma” më e përshtatshme për t’i realizuar qëllimet antishqiptare nga ato që atyre t’u rrënohet etnia e deri te krijimi i mundësive që të shpërnguleshin përgjithmonë.

Ky proces, që si do të shihet, do të vihet në binarë të hapur, do të rrjedhë kahut që ia kishte përcaktuar Beogradi. Madje, ka shumë burime, të cilat bëjnë të ditur se veprimtaria kaçake në Kosovë, e një intensiteti të ultë, edhe përkundër dëmeve që pësonte prej saj (vrasja e ndonjë xhandari, ose ushtari), Beogradit i shërbente për qëllimet e parashtruara, dhe se qeveria e tij bënte përpjekje të vazhdueshme që brenda Lëvizjes të infiltronte bashkëpunëtorë të shumtë, që do ta ashpëronin sjelljen dhe veprimet e saj sipas nevojës, e mbi të gjitha, aty ku Lëvizja rrezikonte të shuhej. Atëherë shërbimet policore dhe ushtarake serbe fusnin njësi të maskuara “kaçakësh”, të cilët vepronin duke vrarë prefektë shqiptarëve dhe “bashkëpunëtorë” të Beogradit dhe këto u visheshin pastaj kaçakëve të njëmendë dhe shfrytëzoheshin si shkas për hakmarrje të gjera ndaj popullatës së pambrojtur.<sup>1622</sup>

---

<sup>1622</sup> Më gjerësisht rreth kësaj shih: Rushiti, Limon: “Lëvizja kaçake në Kosovë 1918-1928”, Prishtinë, 1981; Obradović, Milovan: “Agrarna reforma i kolonizacija Kosova 1918-1941”, Prishtinë, 1981; Bajrami, Hakif: “Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë më 1918-1941”, Prishtinë, 1981; Abdyli, Tahir: “Hasan Prishtina”, Prishtinë, 2003.

Mbi këtë bazë, gjatë vitit 1920/21 u bënë shumë vrasje dhe atentate, ndërkohë që pastrimi i katundeve të tëra shqiptare u shfrytëzua për krijimin e rrethave sa më të përshtatshme për kolonizimin e Kosovës dhe të Maqedonisë Perëndimore me Serbë dhe popullatë tjetër sllave që duhej të vendosej në këto pjesë në përputhje me ligjet për kolonizimin dhe masat e tjera që Beogradi kishte paraparë që ky proces të ishte dy kahesh: në njërin anë që të sillte dhe të vendoste sa më shumë Serbë dhe Malazias në Kosovës dhe Maqedoninë Perëndimore, ndërsa në anën tjetër, të shpërngulte sa më shumë Shqiptarë nga Kosova dhe Maqedonia Perëndimore, gjë që e gjitha duhej të “balancohej” strukturën etnike të Kosovës dhe të Maqedonisë në dëm të asaj shqiptare dhe në dobi të asaj serbe.<sup>1623</sup>

Megjithatë, kur Beogradi po i shfrytëzonte të gjitha mekanizmat shtetërorë dhe ata diplomatikë që t’i arrijë qëllimet e parashtruara ndaj popullatës shqiptare, siç ishte pastrimi i saj etnik me mjetet e luftës, ndërkohë që shteti shqiptar ndodhej në një gjendje tepër të rëndë pse ishte nën trysinë e shumanshme që i vinte nga fqinjët, rezistenca kombëtare në Kosovë ndodhej po ashtu para një sfide të shkëputjes nga brenda dhe të kthimit në një problem të hapur për vetë shtetin shqiptar.

Çështja e parë, pra e shkëputjes nga brenda, paraqiste thujt një fakt të kryer, meqë pas Konferencës së Paqes dhe vendimeve të saj, shfaqeshin dy grupime: ai i lëvizjes së kaçakëve në Kosovë dhe Maqedoninë Perëndimore, i shkapërderdhur po ashtu në shumë pjesë dhe pa ndonjë lidhje të brendshme dhe me mbikëqyrje të vetme, dhe shfaqej edhe Komiteti “*Mbrojtja Kombëtare e Kosovës*”, me qendër në Shkodër dhe me “bazat” e veta në Krumë, Tropojë dhe gjetiu në Veri, që do të detyrohet t’u nënshtrohet disa interesave të jashtme, siç është ajo e pranimit të rolit mbrojtës të Italisë. Edhe pse nga viti 1921 e deri në vitin 1923, si mundësi pikëpjekje do të kenë të ashtuquajturën “*Zonë e Lirë*” e Junikut si dhe hapësirën përreth që lidhte këto pjesë të Shqipërisë me Kosovën, e ku mund të hyhej e dilej, megjithatë, nga viti 1922 kjo do të vështirësohet nga vendosja e vijës kufitare dhe mbikëqyrja e saj, që Tirana zyrtare e kishte kusht nga vendimet e Konferencës së Paqes por edhe nga Lidhja e Kombeve ku ajo ishte pranuar dhe duhej t’i ratifikonte marrëveshjet shtetërore me Greqinë dhe Mbretërinë SKS brenda një afati prej dy vitesh.<sup>1624</sup>

Këtu ka zanafillën edhe çështja e dytë, pra ajo që kishte të bënte me detyrimet e Shqipërisë që të mos lejonte kurrfarë lëvizje irredentiste brenda dhe të mos përkrahte lëvizjet e kaçakëve në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare që i mbante Beo-

<sup>1623</sup> Shih: Obradović, Milovan: “*Agrarna reforma i kolonizacija Kosova 1918-1941*”, Prishtinë, 1981.

<sup>1624</sup> Shih: Verli, Marenglen: “*Kosova sfida shqiptare në historinë e një shekulli*”, Tiranë 2007, faqe 199-206.



gradi. Madje, ajo kishte obligime që, në rast nevoje, bashkë me Beogradin të harmonizonte edhe veprimet, për likuidimin e tyre, siç do të ndodhë pak më vonë.<sup>1625</sup>

Shikuar nga ky këndvështrim rezistenca kombëtare shqiptare shfaqej si Lëvizje Irredentiste brenda shtetit shqiptar dhe si Lëvizje Çlirimtare, brenda shtetit jugosllav. E para dispononte me një potencial të konsiderueshëm intelektual dhe njerëzor, me rreth 20 mijë militantë që do të mund të viheshin në veprim dhe për këtë shikohej me dyshime dhe mosbesim të madh në Shqipëri në rrethanat kur ajo ndodhej në vorbullën e turbullirave të brendshme, ndërsa e dyta ndodhej në Kosovë dhe Maqedoninë Perëndimore, po ashtu me një potencial të konsiderueshëm patriotësh, kryesisht nga shtresa feudale dhe popullsia rurale, të cilët ishin të gatshëm për sakrifica dhe luftë. Mirëpo, përballë kishin një kundërshtar shumë të përgatitur me një aparat të fuqishëm policor-ushtarak, i cili ishte në gjendje mobile dhe në emër të “terrorizmit” kishte dritën e gjelbër që t’i qeronte hesapet me këdo që e fuste në listën e lëvizjes.

Pra, krahas mos lidhjes së brendshme dhe koncepteve të ndryshme politike, kjo lëvizje kishte kundërshtarë të përbashkët: shtetin shqiptar dhe atë jugosllav si dhe faktorin ndërkombëtar. Të parin pse vepronte me logjikën shtetërore, dhe të dytin, pse vepronte në përputhje me konceptet hegjemoniste për zhdukjen e çështjes shqiptare. Ndërsa faktorin ndërkombëtar e kishte për kundërshtarë pse ia ngatërronte hesapet në pazaret e bëra në kurriz të një populli, i cili kërkonte të drejtën të jetojë i lirë dhe i barabartë me të tjerët, por që kjo nuk i lejohej pikërisht nga ata që ishin të thirrur të krijojnë raportet të tilla.

Sidoqoftë, Lëvizja Irredentiste në Shqipëri, në formën më të organizuar, doli në pah drejtpërdrejt në pranverën e vitit 1918, kur në Shkodër, disa nga patriotët shqiptarë nga radhët e lëvizjes kombëtare të viteve 1911/12, që kishin përgatitur pavarësinë e shtetit shqiptar në nëntor të vitit 1912, por që për arsye të rrethanave të njohura ishin privuar nga akti i shpalljes si dhe përmbajtja e shpalljes së Deklaratës së Pavarësisë, ndër ta Hasan Prishtina, Bajram Curri, Hoxhë Kadria dhe të tjerë, shpallën qëllimet e tyre për t’iu bashkuar Shqipërisë me të gjitha mjetet, pa përjashtuar edhe luftën çlirimtare. Këto qëndrime dhe kjo frymë e patriotëve shqiptarë me merita të shumta për pavarësinë kombëtare, do të jetë e pranishme, edhe më herët, por pse kulmoi pikërisht në këtë kohë, arsyet duhet kërkuar te zhvillimet e fundit, që lidheshin me përfundimin e Luftës së Parë Botërore, kur dihej se Fuqitë e Mëdha, pa marrë parasysh kahun e saj, do të mbanin një konferencë të re me të

---

<sup>1625</sup> Shih: Milo, Paskal: “Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927”, Tiranë 1992, faqe 147-151.

cilën do të caktoheshin kufijtë e rinj në Ballkan, gjë që lë për të kuptuar se ideatorët e lëvizjes irredentiste, ishin përgatitur që çështjen shqiptare ta paraqisnin të hapur nga çdo pikëpamje, e cila duhej trajtuar në tërësi dhe jo me shkëputje të dhunshme, siç kishte ndodhur në Konferencën e Londrës. Kështu, përballë këtyre zhvillimeve, kur në lojë pritej të hidheshin sërish kartat e reja, faktori shqiptar detyrohej të dilte me kërkesa të qarta, të cilat duhej të ishin në përputhje me të drejtën për shtetin e tyre të përbashkët mbi baza të shtrirjes etnike, parim ky që kishte shërbyer edhe gjatë themelimit të shteteve të tjera në Ballkan në hapësirën ku për shekuj Perandoria Osmane kishte ushtruar pushtetin e saj. Por që këtë herë ato për mbulesë kishin deklaratën prej 14 pikave të presidentit amerikan Vilson me anën e së cilës edhe Shqiptarëve u takonte e drejta e vetëvendosjes. Me këtë rast duhej të bëhej me dije se ndarja e dhunshme e tyre, jo vetëm që nuk e kishte paqësuar rajonin, siç thuhej, por e kishte bërë edhe më të pasigurt, nga që Shqiptarët nuk ishin pajtuar me ato realitete, të cilat i kishin kundërshtuar edhe me armë.

Natyrisht se në dobi të këtij përcaktimi kishte qenë edhe administrimi afër trevjeçar austro-hungarez (1916-1918) i viseve të pushtuara nga Serbia në vitin 1912 si dhe një pjesë të madhe të Shqipërisë, i cili realitetëve shqiptare ua kishte kthyer identitetin e përbashkët nacional që nga administrata, shkollimi e deri te institucionet, qofshin ato edhe autonome. Gjendja e re tashmë kishte krijuar parakushte që të mos lejohej rikthimi i pushtimit serb dhe malazias, edhe pse Konferenca e Londrës ia kishte përligjur pushtimet në aspektin shtetëror. Kështu, në Shkodër zuri të krijohej edhe struktura organizative e lëvizjes, me ç'rast në krye të saj u zgjodh atdhetari Kadri Pishtina (Hoxha Kadriu), kurse anëtarë të kryesisë, ose bashkëpunëtorë të tij, në kohë të ndryshme qenë Bedri Pejani, Rakip Kaja Begolli, Hasan Prishtina, Bajram Curri, Sali Nivica, Sejfi Vllamasi, Hysni Curri, Elez Isufi, Tafil Boletini, Sadik Rama, Azem Galica, Bajram Daklani, Murat Gjakova, Hasan Ferri, Qazim Bakalli, Beqir Vokshi, Nimon Ferizi, Ismail Haki Nikoçi etj.

Degët e “Komitetit” nisën të themelohen edhe në trevat e tjera shqiptare veriore dhe verilindore, veçmas në pjesën e Maqedonisë Perëndimore. Një degë e komitetit u krijuara edhe jashtë vendit, në Gjenevë, për të mbrojtur lidhjet me kolonitë shqiptare jashtë vendit, duke i dhënë gjithë veprimin një angazhim gjithëpërfshirës, në mënyrë që lëvizja të shfaqej si çështje e drejtë e mbrojtjes së trojeve shqiptare nga ripushtimet sllave. Kjo e drejtë arsyetohej edhe me rrethanat e reja që ishin krijuar nga Lufta e Parë Botërore si dhe heqja dorë e fuqive të mëdha europiane nga garancitë që i ishin dhënë shtetit shqiptar, gjë që njësoj du-

hej të vlente edhe për vendimet e tjera të marra në Konferencën e Ambasadorëve në Londër të vitit 1913.<sup>1626</sup>

Liderët e lëvizjes irredentiste kishin bindjen se Vjena dhe Roma, ndonëse ndodheshin në anë të kundërta të fronteve të luftës, në parim mbeteshin tek mbrojtja e hapësirës shqiptare mbi bazat etnike, gjë që në njëfarë mënyre edhe e kishin shprehur atë: Austro-Hungarezët duke e instaluar autonominë administrative shqiptare në territoret që i mbanin, dhe Roma, duke shpallur madje edhe Shqipërinë autonome nën mbikëqyrjen e Italisë, sado jashtë pushtimeve greke dhe atyre franceze. Edhe përqendrimi i Shqiptarëve duhej të mbështetej te këta faktorë, duke mos përjashtuar edhe marrëveshjet e drejtpërdrejta me këto shtete. Me rëndësi ishte se ideja e shtetit shqiptar, qoftë edhe e shkapërderdhur, ekzistonte dhe ajo nuk ishte e njëanshme. Hasan Prishtina, i cili ishte ndër më të dalluarit e Komitetit *“Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”*, me të drejtë deklaronte se *“çështja e mbrojtjes së tokave shqiptare dhe kthimi i tyre trungut të vet, nuk ishte vetëm detyrë e atyre që kishin humbur atdheun nga pushtimet e fqinjëve, por ishte detyrë e secilit Shqiptar, që e donte Shqipërinë”*.<sup>1627</sup>

Hasan Prishitna, me këtë rast do të përkujtojë edhe gjakun që kosovarët kishin derdhur gjatë mbrojtjes së trojeve të tyre në luftë me pushtuesit serbë dhe malazias, po edhe gjakun që kishin derdhur në mbrojtje të princ Vidit në Durrës dhe në pjesët e tjera nga shtrihej mbretëria Shqiptare e kontestuar dhe e luftuar nga të tjerët, por më shumë nga vetë Shqiptarët dhe këtë të fundit do ta theksojë si luftë vëllavrasëse, e cila nuk guxonte të përsëritej më.<sup>1628</sup>

Nga zhvillimet që do të dalin në pah, as detyrimi i parë - pra që lufta për mbrojtjen e Kosovës dhe kthimi i saj trungut shqiptar të bëhet preokupim i të gjithë Shqiptarëve, nuk do të përmbushet, siç nuk do të tejkalohet as rreziku i përsëritjes së vitit të mbrapsht 1914, kur mbrojtja e shtetit shqiptar do të kthehet në një luftë vëllavrasëse edhe mbi baza fetare.

Në të vërtetë, si aspekti i parë si i dyti i qëndrimit shqiptar ndaj lëvizjes irredentiste, do të shfaqen si aspekt i jashtëm me ndikime të brendshme. Konferenca e Paqes në Paris, përkundër problemeve që do të ketë me njohjen e Shqipërisë në kufijtë e Londrës – dhe kjo do të ndodhë pas më shumë se dy vjet punësh - që në fillim do të njohë së pari Mbretërinë Serbe-Kroate-Slllovene, që pas pak

<sup>1626</sup> Shih: Bajrami, Hakif: *“Si e riokupoi Serbia Kosovën më 1918”*, Prishtinë 2012, faqe 201-205 dhe 326-329; Verli, Marenglen: *“Kosova – sfida shqiptare në historinë e një shekulli”*, Tiranë 2007, faqe 199-201; Abdylil, Tahir: *“Hasan Prishtina”*, Prishtinë 2004, faqe 211-222.

<sup>1627</sup> Shih Hasan Prishtina: *“Nji shkurtim kujtimesh”*, botimi i dytë, Bari, 1925

<sup>1628</sup> Po aty.

do të kthehet në Jugosllavi, paraprakisht duke ia pranuar Serbisë ato që ia kishte dhënë Konferenca e Ambasadorëve në Londër në vitin 1913. Kështu që, Serbia nuk kishte kurrfarë kokëçarje se mos do të humbte viset shqiptare që kishte pushtuar gjatë Luftës së Parë Ballkanike. Përkundrazi, pasi që do të ketë përfunduar Lufta e Parë Botërore, si aleat i Antantës, Beogradi do të presë shpërblimet e shumta (marrja e Vojvodinës, e Baçkës dhe e Banatit nga Hungaria), e do të presë edhe ndonjë pjesë tjetër shqiptare, që tashmë arsyetoheshin si kërkesa “në emër të korrigjimit të sigurisë shtetërore nga lëvizjet irredentiste”.

Qëndrimi ndërkombëtar ndaj Serbisë dhe i njëjti edhe ndaj Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene, që si shtet i përbashkët i Sllavëve të Jugut shfaqej me rëndësinë e një force rajonale, qysh nga fillimi, shtetin shqiptar do ta ballafaqojë me fakte të kryera, pra të humbjes së Kosovës dhe të viseve të tjera që Londra i kishte lënë jashtë shtetit shqiptar, ndërsa lëvizjen kombëtare shqiptare për bashkim, do ta anatemojë “si të rrezikshme ndërkombëtarisht”. Por, jo vetëm kaq. Mbretëria SKS në strategjinë e saj për ta penguar stabilizimin e shtetit shqiptar, do të kombinojë presionet e jashtme dhe të brendshme, të cilat do t’i përdorë të dozuar, që të mos krijojë ndonjë krizë ndërkombëtare, meqë ashtu rrezikonte ndonjë ndeshje të panevojshëm me Italinë, por që ashtu Shqipërinë ta mbajë për laku.

Edhe pse përfaqësuesit e qeverisë së Durrësit në Paris do të theksojnë rëndësinë e viseve të shkëputura dhunshëm nga shteti shqiptar për mbijetesën e tij, faktikisht ata do të përqendrohen te kërkesa e njohjes së Shqipërisë së Londrës dhe shpreheshin të kënaqur po qe se kjo do të përfitojë. Njësoj do të veprojnë edhe qeveria që do të dalë nga Kongresi i Lushnjës, pra ajo e Tiranës, e njëjtë do të sillen edhe të tjerat, që brenda dy viteve të ardhshme do ta ndërrojnë njëra-tjetrën të shumtën me dhunë dhe nën regjinë e shteteve të jashtme, sidomos të atyre fqinje, që nuk ishin të interesuara për stabilizim të shtetit shqiptar.

Lëvizja irredentiste për çlirimin dhe bashkimin e trojeve shqiptare që do të udhëhiqej nga Komiteti “*Mbrojtja Kombëtare e Kosovës*”, si potencial i fuqishëm, sa më shumë që do ta humbë “legjitimitetin” nga jashtë dhe sa më shumë do ta humbë hapësirën e veprimit në truallin e vet, sidomos në viset e pushtuara kur lufta kundër pushtuesve serbë do të rrudhet në disa grupe kaçake të shkëputura, që do të vepronin në trekëndëshin midis Drenicës, Drinit dhe Dukagjinit përderisa do tëshuhen fare.<sup>1629</sup> Si e tillë, do të kthehet në një problem të brendshëm shqiptar, që do të

---

<sup>1629</sup> Më gjerësisht rreth lëvizjes kaçake në Kosovë shih te Rushiti, Limon: “*Lëvizja Kaçake në Kosovë 1818-1928*”, Prishtinë, 1981; Haxhiu, Ajë: “*Shote dhe Azem Galica*”, Tiranë, 1976; Haxhiu, Ajë: “*Hasan Prish-*

reflektojë në skenën e saj politike, duke u përfshirë në disa zhvillime, të cilat me kohë, do t'i kthehen në bumerang për t'u likuiduar fare, siç do t'i ndodhë para dhe pas grusht-shtetit të qershorit të vitit 1924. Komiteti “*Mbrojtja Kombëtare e Kosovës*” do të vihet në anën e “të majtës” shqiptare, kundër “të djathtës”, paçka se kjo ndarje ishte më shumë i natyrës politike se sa raport i njëmend shoqëror, me çka do ta vulosë fatin e vet në atë mënyrë, që edhe po qe se do të fitonte e majta fundin do ta kishte të njëjtë, por jo me anë të gjakut. Sepse, ishte logjika e interesit shtetëror që ia përcaktonte këtë fat, deshi ose nuk deshi kjo të pranohet.

Përkundër këtij zhvillimi, duhet thënë se Komiteti “*Mbrojtja Kombëtare e Kosovës*” me seli në Shkodër, i themeluar në rrethanat kur Lufta e Parë Botërore hynte në fazën përfundimtare, ndërkohë që në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare tashmë kishin hyrë forcat franceze të cilat kishin filluar t’ua rikthenin ato Serbëve, ishte i domosdoshëm, meqë pritej që në një konferencë ndërkombëtare, që duhej të mbahej, e gjithë çështja e vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër të rishikohej në përputhje me raportin e ri të forcave që po e nxirrte epilogu i luftës botërore si dhe të interesave që kishin dalë në pah. Andaj, Shqiptarët kërkonin që faktorit ndërkombëtar të vendosjes paraprakisht t’i jepej përgjigjja e tyre, veçmas ku do të bëhej fjalë edhe për fatin e Kosovës dhe të viseve të tjera të shkëputura nga trugu i saj gjatë Luftërave Ballkanike nga Serbët dhe Malaziasit. Kjo kërkesë nuk duhej të ishte tjetër pos të përfshinte atë për shtetin e bashkuar shqiptar në përputhje me të drejtën etnike, historike dhe jetësore të tyre, siç e kishin edhe të tjerët që kishin dalë nga robëria shumëshekullore osmane, e drejtë kjo që tashmë fuqizohet edhe me deklaratën për vetëvendosjen e popujve të presidentit amerikan Wilson, të vitit 1918, e cila do të kthehet në një platformë për zgjidhjen e shumë çështjeve që u shfaqën pas Luftës së Parë Botërore pas shembjes së Perandorisë Austro-Hungareze, disfatës së Gjermanisë si dhe rrënimit të Perandorisë Osmane.

Këto aspirata do t’i shprehë edhe programi i Komitetit, i cili kërkonte që në Shqipërinë etnike të përfshiheshin tokat duke u nisur nga Sanxhaku i Jeni Pazarit, Kosova, Dukagjini për të vazhduar pastaj me viset shqiptare në Maqedoni nga Kumanova, Shkupi, Tetova, Gostivari e në drejtim të kufirit të Greqisë.<sup>1630</sup>

---

*tina dhe lëvizja patriotike e Kosovës*”, Tiranë, 1964; Çami, A: “*Lufta çlirimtare antiimperialiste e popullit shqiptar 1918-1920*”, Tiranë, 1969; Cana, Zekeria: “*Shpalime historike*”, Prishtinë, 1982.

<sup>1630</sup> Shih proklamaten e Komitetit “*Mbrojtja Kombëtare e Kosovës*” te Bajrami, Hakif: “*Si e riokupoi Serbia Kosovën më 1918*”, Prishtinë 2012, faqe 201-203.

Kur forcat e Antantës u futën në trojet shqiptare dhe me këtë forcat e Boshtit u shpallën humbëse të luftës, Komiteti do t’u drejtohet Fuqive të Mëdha me kërkesën që të realizohej programi kombëtar.<sup>1631</sup>

Kështu, pos këtyre kërkesave, vendeve të Antantës Komiteti ua drejtoi edhe një protestë kundër mizorive sllave në Kosovë dhe krahinat e tjera shqiptare të ripushtuara prej tyre. E tillë është ajo që Komiteti ia drejtoi më 4 dhjetor nga Shkodra 1918 Konferencës së Paqes në Paris. Aty, pos të tjerash thuhet:

“Serbët, duke arritur të rivendoseshin më 1918 brenda kufijve të tyre politikë në saje të ushtrive të Fuqive të Mëdha, të Antantës, filluan të zbatojnë përsëri metodën mizore të lartpërmendur, bombarduan dhe bënë rrafsh shtatë fshatra të Pogurit (rrethi i Pejës), internuan shumë nga anëtarët e parisë së Prishtinës, plaçkitën tregun e Pejës dhe, pas të gjitha këtyre, detyruan nja dhjetë veta nga Peja dhe Gjakova të merrnin pjesë në Kongresin nacionalist serbo-malazet të Podgoricës.”<sup>1632</sup>

Por, në përputhje me ndryshimin e rrethanave, të cilat tashmë shfaqeshin fare të ndryshme nga ato të Konferencës së Ambasadorëve të Londrës të vitit 1912 kur Fuqitë e Boshtit (Austro-Hungaria, Gjermania dhe Italia) kishin fjalën kryesore edhe ato kishin mbrojtur interesat e Shqipërisë qoftë të përgjysmuar, pra kur në krahun e Fuqive të Antantës si aleatë të tyre shfaqeshin edhe shtetet fqinje (Serbia dhe Greqia), të cilat kishin pretendime të hapura për ta rrënuar edhe Shqipërinë londineze, “Komiteti” do të mundohet që t’u përshtatet këtyre realiteteve, duke parë Italinë si të vetmen mbështetëse. Meqë Italia, ndonëse fillimisht si pjesëtare e Fuqive të Boshtit, kishte abstenuar nga lufta, ndërkohë që më vonë i ishte bashkuar Antantës dhe madje, bazuar në disa marrëveshje të fshehta me Britanikët dhe Francezët që kishin bërë për ta përfshirë atë në anën e tyre, kishte marrë premtimin se do të ketë fjalën kryesore rreth çështjes shqiptare, atëherë ishte e pritshme që “Komiteti” të kërkonte mbështetje te Italia, e cila shfaqej frenuesi kryesor kundër pretendimeve hegjemoniste të Beogradit dhe të Greqisë ndaj tokave shqiptare. Madje, “Komiteti” përkrahu depërtimin e italianëve drejt veriut, veçmas për të penguar që Shkodra t’u bjerë në dorë Serbëve dhe bëri thirrje që Shqiptarët të përcaktohen për Italianët. Kështu, në janar të vitit 1919, duke pasur parasysh rolin e Italisë në Konferencën e Paqes, Komiteti “Mbrojtja e Kombëtare e Kosovës” i shpalli pikëpamjet e veta ndaj mendimeve të qeverisë italiane dhe franceze, ku pos të tjerash thuhej se qëllimi kryesor i Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” është që të vendosë një

---

<sup>1631</sup> Po aty, faqe 292.

<sup>1632</sup> Shih: Bajrami, Hakif: “Si e riokupoi Serbia Kosovën më 1918”, faqe 292-296 Pushkollli, Fehmi: “Mbrojtja Kombëtare shqiptare e Kosovës 1878-1990”, Prishtinë, 1991, faqe 80.

Shqipëri independente të përjashtuar nga çdo formë protektorati, dhe të shpëtojë Kosovën bashkë me viset shqiptare në Maqedoni e t'i bashkojë me Shqipërinë. Kushtet që janë në kundërshtim me këtë qëllim të lartë, Komiteti i refuzon.

Me këtë rast përcaktimi për të ndjekur politikën italiane arsyetohej me atë se qeveria italiane dëshiron ta largojë nga verilindja qeverinë jugosllave që po krijohet, dhe meqenëse kjo çështje është në interes të Komitetit tonë, Komitet ynë, në këtë pikë, ka besim në përkrahjen e Italisë.

Po ashtu, Komiteti thekson se Italisë nuk duhet bërë kurrfarë lëshimesh rreth pretendimeve të saj territoriale në Shqipëri ose që të vendosë protektoratin mbi Shqipërinë. “Kjo punë duhet të kryhet me kujdes për shkak që ishte e nevojshme të shpëtohet Kosova”.<sup>1633</sup>

Por, si do të shihet nga ajo që do të ndodhë në Konferencën e Paqes në Paris dhe përreth, kërkesat e Komitetit “*Mbrojtja Kombëtare e Kosovës*” nuk do të përfillen nga Fuqitë e Mëdha, meqë Mbretëria Serbe-Kroate-Slllovene tashmë ishte një realitet i ri në Ballkan, si një faktor tepër i rëndësishëm i cili plotësonte zbrazëtirën që ishte krijuar nga shembja e dy perandorive më të mëdha të kohës, asaj austro-hungareze dhe osmane. Kjo, jo vetëm nxirrte nga loja çfarëdo koncepti të faktORIZIMIT të Shqiptarëve në përmasa rajonale, por hapte edhe çështjen e defaktORIZIMIT të mëtutjeshëm të vetë shtetit shqiptar pikërisht, që t'i hiqej çfarëdo mundësie që të kthehej në një mbështetës të aspiratave të Shqiptarëve për t'u bashkuar. Beogradi, madje, bëri përpjekje që e gjithë çështja shqiptare të kthehet te Marrëveshja e Fshehtë e Londrës e vitit 1915 kur ajo parashihej që të rrudhej te përmasat e një “Principate myslimane” (me Esat Pashë Toptanin në krye), që edhe do të mund të merrte mbështetje, po mos të ishte ndërhyrja amerikane e presidentit Vilson e shkurt-marsit të vitit 1920 kur së pari do të hedhë poshtë kompromisin anglo-franko-italian të 13-14 janarit 1920 që parashikonte shkëmbimin e Fiumit (Rijekes) me Shkodrën dhe pastaj kërkoi që çështja shqiptare të ndahet nga “çështja e Adriatikut”, pra që të mos lejohet copëtim midis Romës dhe Beogradit.

Nga ky moment Beogradi do të bëjë përpjekje, që me ndonjë korrigjim të vogël, të mbështesë konceptin e Shqipërisë londineze në mënyrë që Italianëve t'u pengohet ndikimi i tyre në këtë pjesë. Meqë rivaliteti midis Beogradit dhe Romës për Shqipërinë dhe Shqiptarët në përgjithësi nuk shfaqej më vetëm si çështje brenda këtyre dy vendeve, por edhe e rivaliteteve midis vetë vendeve të Antantës (atij francez për një Antantë të Vogël të përbërë nga shtetet që kishin dalë nga shpërbër-

---

<sup>1633</sup> Po aty, faqe 81.

ja e Perandorisë Austro-Hungareze dhe të Britanikëve, të cilët kërkonin një Antantë të Madhe sipas interesit amerikan, ku Italia dhe Greqia shfaqeshin si faktorë vendimtar). Kjo do t'i ndihmojë Shqipërisë dhe Shqiptarëve në përgjithësi që të gjenden në një pozitë më të mirë nga ajo që u parashihej pas rrënimit të vendeve të Boshtit (Austro-Hungarisë dhe Gjermanisë) mbështetësve të saj kryesorë.

Në përputhje me këtë zhvillim, Shqipëria si shtet do të fitojë gjasa të mira mbijetimi dhe forcimi, me kusht që të mos ngulfatet nga brenda siç i kishte ndodhur në prag të Luftës së Parë Botërore. Ndërsa çështja e Kosovës dhe në përgjithësi e viseve të mbetura në Mbretërinë SKS ( Maqedonia Perëndimore dhe Plava e Gucia) do të kthehet në çështje të pakicave, në përputhje me konventat ndërkombëtare dhe pakoja e të drejtave kulturore dhe fetare që kishte hyrë në fuqi me Konventën e Lidhjes së Kombeve.



## KAPITULLI I DYTË

### POLITIKA ANTISHQIPTARE E BEOGRADIT

#### FILLIMI I KOLONIZIMIT TË VISEVE SHQIPTARE

Kolonizimi i Kosovës dhe atyre në Maqedoninë Perëndimore si dhe viseve të tjera të pushtuara shqiptare gjatë Luftërave Ballkanike, të cilat Konferenca e Londrës më 1913 dhe e Parisit më 1919 ia njohu Beogradit, ishte një ndër qëllimet kryesore të programit nacional të hegjemonizmit serbomadh, që kishte të bënte me kthimin e baraspeshës etnike në këto pjesë nga ajo shqiptare, siç ishte, te ajo serbe, siç planifikohej. Ky projekt, i cili filloi të zbatohet nga dita që ushtritë serbe dhe malaziasë pushtuan viset shqiptare, ishte i lidhur ngushtë edhe me shpërnguljen e Shqiptarëve nga trojet e tyre etnike, që në forma të ndryshme, do të vazhdojë pas Luftës së Parë Botërore deri te Lufta e Dytë Botërore, për të vazhduar edhe më tutje.

Kolonizimi kishte tri faza: e para nga pushtimet e deri në fund të vitit 1915; e dyta nga viti 1921 deri më 1931 dhe e treta nga viti 1931 deri më 1941.

Faza e parë mbështetej mbi veprimet individuale, pra të kolonëve (*naselenici*), që shfrytëzonin dekretet për bashkimin e trojeve “të çliruara” të të ashtuquajturës Serbi e Vjetër, siç quheshin asokohe Kosova dhe Maqedonia nga Mbretëria e Serbisë dhe e Malit të Zi. Në këtë fazë, deri sa do të nxirret “*Dekreti për popullzimin e viseve jugore*” i vitit 1920, kolonët kanë marrë aq tokë sa kanë qenë në gjendje ta punojnë me familjet e tyre. Tokë kanë marrë të gjithë ata që kanë shfaqur gatishmëri të shkojnë në Kosovë dhe në Maqedoni për të jetuar, pa marrë parasysh se janë apo jo bujq.<sup>1634</sup>

Në fazën e dytë bën pjesë kolonizimi nga viti 1921 deri në vitin 1931, i mbikëqyrur nga organet shtetërore, i cili mbështetet mbi reformën agrare. Ai në të

---

<sup>1634</sup> Më gjerësisht shih: Obradović, Milovan: “*Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu 1918-1941*”, Prishtinë 1981, faqe 21-25; Bajrami, Hakif: “*Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë 1918-1941*”, Prishtinë 1981, faqe 41-43; Osmani, Jusuf: “*Kolonizimi, reforma agrare dhe shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova 1918-1941*” I, II, III, Prishtinë, 2016, faqe 15-39 dhe 61-74.

vërtetë, në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare, ka pasur për qëllim ndryshimin me dhunë të strukturës kombëtare në dëm të asaj shqiptare dhe në dobi të asaj serbe. Në këtë fazë, rëndom manipulohej me atë se reforma agrare ndryshonte marrëdhëniet e vjetra pronësore feudale në dobi të bujqve, ku shteti ishte bartës i pronës, ndërsa shfrytëzuesit e saj pronarë të përkohshëm me marrëveshje në përputhje me ligjet që përcaktonte shteti. Kolonëve u ndaheshin tokat djerra, pyjet si dhe ato të ekspropriuara nga shteti. Edhe këtu kolonët kishin mundësi të zgjidhnin tokat më të mira, meqë si toka “djerra”, përfshiheshin pronat e shqiptarëve të dëbuar me dhunë, atyre që ishin zhvendosur në Shqipëri gjatë Luftërave Ballkanike dhe asaj Botërore, ose që ishin shpërngulur përgjithmonë në Turqi.<sup>1635</sup>

Në fazën e tretë, nga viti 1931 e deri më 1941, kolonëve u jepej edhe toka e punueshme, që u takonte Shqiptarëve.

Në të gjitha fazat ndarja e tokave bëhej në bazë të ligjeve të shpallura rreth Reformës Agrare, që hyri në fuqi më 27 gusht 1920.<sup>1636</sup>

Megjithatë, kur bëhet fjalë për fazën e parë, pra atë nga pushtimet serbo-malaziane të viseve shqiptare, duhet theksuar se kanë ekzistuar raporte “të ndryshme”, meqë Kosova dhe viset e tjera shqiptare ishin ndarë në dy pjesë. Dukagjinin e kishte pushtuar Mali i Zi, ndërsa pjesën tjetër të Kosovës bashkë me Maqedoninë e kishte pushtuar Serbia. Kufiri i këtyre në Dukagjin ndiqte Drinin dhe Bistricën, ndërsa Gjakova ishte ndarë në dy pjesë, ku ana lindore e lumit Krena i takonte Malit të Zi, ndërsa perëndimorja Serbisë.

Në pjesën e Serbisë, nga pushtimi e këndeje, secili serb ishte i lirë të merrte tokë sa mendonte se mund ta punonte, pa çarë kokën se ishte “e shtetit” apo e Shqiptarëve. Meqë Shqiptarët nuk trajtoheshin si qytetarë “të Serbisë së re”, por “dhunues”, prej të cilëve duhej mbrojtur Serbët me anën e aparatit policor-ushtarak dhe masa të tjera, kjo vlente edhe për pronën e tyre të përvetësuar, e cila “legjitimohej” me “tapitë historike dhe shpirtërore” serbe ndaj të cilave ata humbin çdo të drejtë.<sup>1637</sup>

Kjo gjendje vazhdoi deri më 20 shkurt 1914 kur Serbia nxori “*Urdhëresën për kolonizimin e viseve të çliruara dhe të aneksuara të Mbretërisë Serbe*” si dhe plotësimet që do t’i bëhen më 5 maj të atij viti.<sup>1638</sup>

---

<sup>1635</sup> Obradović, po aty, vepra e cituar, faqe 33.

<sup>1636</sup> Obradović, Milovan: “*Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu 1918-1941*”, Prishtinë, 1981, faqe 134.

<sup>1637</sup> Po aty.

<sup>1638</sup> Më gjerësisht shih: Krsitë, Đorđe: “*Kolonizacija Južne Srbije*”, Sarajevë, 1928; Urošević, Atanasije: “*Agrarna reforma i naseljavanje*”, Shkup, 1937, faqe 826-833; Novaković, Kosta: “*Kolonizimi dhe serbizimi i Kosovës*”; Erić, Milivoje: “*Agrarna refoma u Jugoslaviji 1918-1941*”, Sarajevë, 1958, faqe 107; Hadri,

Në të vërtetë, pas nxjerrjes së këtij dekreti, gjoja për të krijuar rrethanat për fillimin e Reformës Agrare si dhe për të vendosur rend mbi pronën shtetërore, Beogradi filloi të legjitimojë të gjitha uzurpimet dhe marrjen e tokave që ishin bërë nga Serbët vendorë, por edhe kolonët “vullnetarë” të cilët ishin shfaqur menjëherë pasi që ushtria serbe të kishte vënë mbikëqyrjen në territoret e pushtuara. Një drejtori e posaçme, e cila ishte ngritur në përbërje të Ministrisë së Pylltarisë dhe të Ekonomisë Popullore, kishte marrë përsipër mbikëqyrjen e këtij procesi me shpërndarjen e tapitë Serbëve, ndërsa Shqiptarëve u kushtëzoheshin me shumë formalitete thuajse të papërbalueshme.

Lufta e Parë Botërore ndërpreu kolonizimin e organizuar shtetëror të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare të pushtuara gjatë Luftës së Parë Ballkanike. Me të filluar lufta, thuajse të gjithë kolonët ishin larguar nga Kosova.<sup>1639</sup>

Në pjesën e Kosovës të pushtuar nga Mali i Zi (Dukagjini dhe një pjesë e Drenicës), kolonizimi filloi menjëherë pas vendosjes së pushtetit okupues. Mali i Zi kishte formuar Komisionin Agrar, i cili në dhjetor të vitit 1913 kishte filluar punën me regjistrimin e pronave, të shtëpive si dhe të tokave që i takonin shtetit dhe manastireve. Komisioni Agrar kërkonte dëshmi pronësore nga Shqiptarët, tapi, që ishin më të vjetra se 50 vjet. Meqë shumica e Shqiptarëve nuk kishin mundësi t'i siguronin ato, pasi që pushteti osman kishte marrë me vete të gjithë regjistrat kadastralë, ndërkohë që tapitë e tilla mund të siguroheshin vetëm po qe se shkohej në Turqi (gjë që ishte e pamundur), atëherë, shteti malazias deklaronte për pronë “shtetërore” secilën tokë që nuk mund t'i dëshmohej pronësia e përcaktuar sipas rregullores së shpallur nga Komisioni Agrar.<sup>1640</sup>

Që çështjes “së reformës agrare” t'i jepej “mbështetje ligjore”, e cila nuk kishte qenë tjetër pos uzurpim me dhunë të tokës së Shqiptarëve dhe dhënies së saj kolonëve, ashtu siç kishte vepruar edhe Mbretëria Serbe ditë më parë, edhe Mali i Zi, më 27 shkurt 1914, kishte shpallur ligjin për popullimin e viseve të çliruara të Malit të Zi. Me këtë ligj, shteti shpallte pronë të veten të gjitha tokat që nuk mund të dëshmoreshin me anën e tapive si prona private. Me këtë ligj, vetëm në rrethin e Gjakovës, Komisioni Agrar ndau 26 mijë rala tokë (një *ral* kishte

---

Ali: “Marrëdhëniet agrare dhe lufta e PKJ në Kosovë dhe Metohi kundër Reformës Agrare të padrejtë të Jugosllavisë borgjeze”, “Përparimi”, 1964, nr. 9, faqe 589-599; Obradović, Milovan: “Agrarna Reforma i kolonizacija na Kosovu 1918-1941”, Prishtinë, 1981; Osmani, Jusuf: „Kolonizimi, reforma agrare dhe shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova 1918-1941“, I,II, III, Prishtinë, 2016.

<sup>1639</sup> Rushiti, Limon: “Lëvizja Kaçake në Kosovë 1918-1928”, Prishtinë 1981, faqe 18; Bajrami, Hakif: “Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë më 1918-1841”, Prishtinë 1981.

<sup>1640</sup> Më gjerësisht shih Pejović, Đoko: “Agrarna politika crnogorske vlade u krajevima oslo-bođenim u balkanskom ratu 1912“, Istorijasi zapisi, 1-2, 1955, faqe 216.

vlerën 40 ari), në të cilat duhej të vendoseshin 500 familje të kolonëve.<sup>1641</sup> Kështu, një familje e thjeshtë merrte pesë hektarë tokë falas, ndërsa për çdo anëtar tjetër merrte dhe nga 50 ari (gjysmë hektari). Po ashtu, familjet merrnin falas edhe 50 ari për shtëpi dhe oborre. Kolonët ishin liruar nga tatimet në tokë dhe bagëti për tri vjet si dhe nga të gjitha tatimet e shtetit, pos atyre të kishave dhe të shkollimit.<sup>1642</sup>

Në viset e Malit të Zi, e gjithë puna e Komisionit Agrar është mbikëqyrur nga gjenerali Veshoviq, i cili ka pasur fjalën kryesore për të gjitha çështjet. Gjenerali Veshoviq, i njohur për masakrat ndaj popullatës së Dukagjinit, kishte angazhuar gjithë potencialin ushtarak që krahas mbrojtjes së plotë që u ishte dhënë kolonëve dhe veprimeve të tyre për të uzurpuar tokë sipas dëshirës, njëherësh kishte bërë përpjekje që me anën e masave të ndryshme të represionit, ndër të cilat kishte qenë edhe kthimi i dhunshëm i Shqiptarëve të besimtarëve myslimanë dhe atyre katolikë në fenë ortodokse, të përshpejtojë shpërnguljen e Shqiptarëve në Turqi, por edhe të dëbojë të tjerët në Shqipëri. Përpjekjet e tij për t'i arritur këto qëllime ishin përqendruar në Pejë dhe në pjesët kufitare me Shqipërinë. Këto të fundit, për shkaqe të sigurisë nacionale, por edhe të mbrojtjes së manastireve ortodokse (atij të Deçanit dhe të Pejës), ishin paraparë të ktheheshin “në zona të pastra serbe”.<sup>1643</sup>

Por, këtë proces e kishte ndërprerë Lufta e Parë Botërore. Me shfaqjen e ushtrive austro-hungareze dhe atyre gjermane në pjesët e Dukagjinit, kolonët ishin larguar bashkë me ushtrinë pushtuese malaziasë, e cila ishte tërhequr nga Peja në drejtim të Çakorrit për në Mal të Zi, ndërsa Shqiptarët kishin kthyer pronat e tyre si dhe të drejtat kombëtare (shkollimin në gjuhën shqipe, autonominë lokale, vetëqeverisjen dhe të tjera), që nuk i kishin pasur deri më atëherë dhe me të drejtë ata i kishin marrë për çlirimtarë.<sup>1644</sup>

Përfundimi i Luftës së Parë Botërore Shqiptarëve të pushtuar nga Serbia, Mali i Zi dhe Greqia, do t'ua kthejë pushtuesit e njëjtë, me të vetmin ndryshim se Serbia dhe Mali i Zi tashmë ishin bashkuar me Kroatët dhe Sllovenët, të cilët, pas shpërbërjes së Austro-Hungarisë, më 1 dhjetor 1918, kishin shpallur bashkimin e tyre në Mbretërinë Serbe-Kroate-Sllovene, shtet ky i ri, ndër më të fuqishmit e rajonit, që do të njihet nga Konferenca e Paqes në Paris.

---

<sup>1641</sup> Po aty, faqe 217.

<sup>1642</sup> Po aty.

<sup>1643</sup> Po aty.

<sup>1644</sup> Shih: Abdyli, Tahir: “*Hasan Prishtina*”, Prishtinë 2004, faqe 199-201.

Krijimi i këtij shteti të fortë, krijoi rrethana edhe më të përshtatshme për borgjezinë hegjemoniste serbomadhe, që t'i çojë më tutje projektet e saj për shkombëtarizimin e Kosovës dhe pjesëve të tjera të banuara me Shqiptarë (në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në Sanxhak), me ç'rast reforma agrare e shtetit të përbashkët kthehet në mjet të rëndësishëm të arritjes së këtij qëllimi.

Të kësaj kohe janë faza e dytë e kolonizimit (1921-1931) si dhe ajo e treta e kolonizimit (1931-1941).

Kolonizimi i Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare të mbetura nën Mbretërinë SKS filloi menjëherë pas themelimit të shtetit të përbashkët, i drejtuar nga borgjezia serbomadhe e Beogradit.

Me masa urgjente dhe me dekrete të jashtëzakonshme, filloi kthimi i familjeve "të përzëna" nga Kosova nga viti 1915 e tutje, kur në këto pjesë do të shfaqet ushtria austro-hungareze dhe gjermane për t'i dhënë fund pushtimit serb dhe malazias. Kthimi i tyre në masë filloi nga janari i vitit 1919, pra menjëherë pasi që regjenti Aleksandër Karagjorgjeviq shpalli monarkinë e tre popujve (Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve), të cilëve u premtonte se do të bëhen zot të tokës së tyre.<sup>1645</sup>

Në këtë manifest proklamohej ndërprerja e raporteve feudale në dobi të parimit të ri se toka i takon atij që e punon. Kjo do të thoshte se çifligarët e deridjeshëm shpronësoheshin (me kompensim të shtetit), ndërkohë që çifçinjtë, bëheshin pronarë të tokës në përputhje me ligjet e Reformës Agrare, të cilat ishin specifike për pjesë të ndryshme, meqë marrëdhëniet shoqërore nuk kishin qenë të njëjta në pjesët ku kishte qenë Monarkia Austro-Hungareze me ato osmane.

Ndonëse eliminimi i feudalizmit dhe kthimi i të drejtës së pronës së tokës atyre që e punonin në përputhje me Reformën Agrare, do të duhej të paraqiste një kthesë pozitive edhe për Shqiptarët - meqë edhe atyre ua hiqte sistemin çifligar, bejlerët, agallarët dhe strukturat e tjera feudale - kjo nuk do të ndodhë. Sepse, raportet e reja, do të krijojnë një pronar të ri - shtetin, ndërkohë që ata shpronësoheshin jo për t'u pronësuar sipas reformës dhe rregullave të saj që do të duhej të vlenin për të gjithë njësoj, por për të krijuar një shtresë të re pronësore, e cila shfaqej si pushtuese dhe me të drejtën e uzurpuesit që e kishte nga Ligji për bashkimin e tokave të çliruara nga viti 1914 e këndej, kur secili Serb dhe kolon mund të përvetësonte dhe të uzurponte tokë sipas dëshirës, pa çarë kokën se atë e merrte nga Shqiptarët ose nga pronat djerra, të mbetura pa zot nga shpërngulja e pronarëve të tyre të njëmendtë që ishin shpallur prona të shtetit.

---

<sup>1645</sup> Shih E. Šišić: "Dokumenti o postanku Kraljevine SHS 1914-1919", Zagreb, 1920, faqe 180.

Kështu, në Kosovë nga viti 1919 e deri në vitin 1921 kolonizimi shkoi nëpër tri mënyra të ndryshme, por që kishin të njëjtin qëllim përvetësimin e pjesës më të madhe të tokave të saj. Ky zhvillim nga qeveritarët e Beogradit do të quhet “popullzim” i Kosovës.

Mënyra e parë quhej “kolonizim i brendshëm” dhe kishte të bënte me zbritjen masive të Serbëve nga pjesët kodrinore-malore, siç ishin ata të Sharit drejt rrjedhës së Lepencit dhe të Sitnicës nëpër pllajrat dhe fushat pjellore të Kosovës, ata të Sredskës drejtë Prizrenit dhe fushave përreth si dhe ata të Kollashinit të Ibrit në drejtim Drenicës dhe të Mitrovicës.<sup>1646</sup>

Mënyra e dytë ishte kolonizimi i Kosovës me kolonë malazias. Ata kërkonin të vendoseshin në Metohinë e Pejës, në Drenicë dhe ndonjë në Kosovë.<sup>1647</sup> I njëjti burim bën të ditur se Malaziasit, rëndom vinin vullnetarë në pjesën e Dukagjinit dhe në Drenicë, që më parë të zgjedhur. I venin shenjat dhe kërkonin që t’u ndihmohej për ndërtimin e shtëpive. Po ashtu, kërkonin që ushtrinë dhe policinë ta kishin pranë, edhe pse edhe vetë ishin të armatosur.<sup>1648</sup>

Mënyra e tretë e kolonizimit ishte ajo me kolonë vullnetarë nga Hercegovina dhe Dalmacia. Bëhet e ditur se kërkesat e tyre ishin shumë më të mëdha se ato të malaziasve. Sepse, krahas tokës së punueshme, që kishte ujë, po ashtu kërkonin shtëpi të reja pranë rrugëve me komunikime të mbrojtura. Ata kërkonin edhe bagëti dhe prani të policisë dhe të ushtrisë kudo.

Megjithatë, edhe përkundër mundësive tepër të mëdha për të uzurpuar tokë të pëlleshme dhe për të fituar të drejtën “e pronës shtetërore”, gjatë vitit 1919 dhe 1920 nuk vërehet ndonjë kolonizim i madh. Sipas statistikave zyrtare gjatë vitit 1919 në Kosovë janë vendosur gjithsej 33 familje, prej tyre 28 në rrethin e Nerodimës. Ndërsa në vitin vijues ky numër do të dhjetëfishohet. Numri më i madh i familjeve të vendosura do të jetë në Pejë (125 sosh), ndërsa 77 familje do të vendosen në Istog, Podujevë 28 dhe kështu me radhë. Për kolonët do të ndërtohen 130 shtëpi.<sup>1649</sup>

Se kolonët në Kosovë merrnin tokë sipas dëshirës, edhe pse me Reformën Agrare në gjithë vendin maksimumi parashihe pesë hektarë, kjo dëshmohet me disa raste kur majori aktiv i armatës, Medenica, do të marrë 18 hektarë tokë në

---

<sup>1646</sup> Raporti i të ngarkuarit kryesor të Ministrisë së Reformës Agrare në Shkup, Sreten Vukosavljeviq, nr. 235, të 28. VIII .1919, nga Arkivi i Jugosllavisë, fondi i Reformës Agrare 1918-1941.

<sup>1647</sup> Po aty.

<sup>1648</sup> Po aty.

<sup>1649</sup> Obradović, Milovan: “Agrarna reforma na Kosovu 1918-1941“, Prishtinë, 1981, faqe 136.

Vitomiricë, ndërsa mësuesi Klajiq në Malishevë mori 27 hektarë tokë.<sup>1650</sup> Madje, ndër ata që shfaqeshin pronarë të mëdhenj tokash në Kosovë ishte edhe kryeministri Nikolla Pashiq, i cili në Gazimestan të Fushës së Kosovës, kishte 300 hektarë tokë, që i kishte përvetësuar nga fondi shtetëror me arsyetimin e një përmendoreje “heronjve” të Betejës së Kosovës të vitit 1389.<sup>1651</sup>

Nga vitit 1920 kur do të sillet Ligji për kolonizimin e viseve jugore e deri në vitin 1931, kur ai do të plotësohet me disa “udhëzime” të natyrës formale dhe joqenësore, do të vazhdojë diskriminimi i Shqiptarëve në planin ligjor dhe administrativ. Ky diskriminim ishte i hapur dhe gjithnjë arsyetohet “me masat për rikthimin e popullatës serbe në trojet e vjetra” në rrethanat e “gjendjeve të jashtëzakonshme” të krijuara nga “lëvizja terroriste kaçake”, dhe po ashtu do të arsyetohet edhe me “interesin nacional kombëtar”, gjë që të përkthyer me gjuhën politike ato lidheshin me projektet hegjemoniste serbo-mëdha për shkombëtarizimin e Kosovës dhe të Maqedonisë me anën e shtimit të numrit të popullatës serbe me anën e kolonizimit dhe të shpërnguljes së Shqiptarëve për në Turqi dhe gjetiu. Kështu, diskriminimi i parë do të jetë ai që ka të bëjë me të drejtën e pronës, ku Serbët dhe Malaziasit përfitonin pesë hektarë tokë për familje, duke përfshirë këtu edhe nga gjysmë hektari për çdo fëmijë si dhe gjysmë hektari për shtëpi dhe gjysmë hektari për oborr, pa përjashtuar këtu edhe kreditë që merrnin nga shteti, ndërsa Shqiptarët mund të merrnin maksimum dy hektarë për familje pa të drejtën e shtesave për fëmijë dhe anëtarët e tjerë. Kur dihej se familjet shqiptare ishin të mëdha, rrudhja në vetëm dy hektarë, i kthente në varfanjakë. Pore, edhe për të siguruar dy hektarë, duhej t’i kapërcenin shumë barriera administrative e gjyqësore, nga deklarimi i lojalitetit ndaj shtetit jugosllav (nënkuptonte nënshtetësinë) e deri te formalitetet e tjera zyrtare, të cilat mund të përballloheshin vetëm me anën e korrupsionit që jo rrallë kapte gjysmën e pronës. Në pamundësi t’i përballonin të gjitha këto vështirësi shumë nga Shqiptarët përcaktoheshin për t’u shpërngulur në Turqi, meqë ashtu shpëtonin nga ndjekjet, nga nënçmimet dhe terrori shtetëror.

Një masë tjetër që diskriminonte Shqiptarët dhe i shtynte për t’u shpërngulur në Turqi ishte edhe ajo që kishte të bënte me “pronën e kaçakëve”, e cila kthehej në pronë shteti, që pastaj u jepej kolonëve.

Sipas urdhëresës së vitit 1926, e cila mbështetej në atë të vitit 1922, shteti kishte të drejtë të konfiskonte tokën dhe gjithë pasurinë e kaçakëve, por edhe të

---

<sup>1650</sup> Po aty, faqe 137.

<sup>1651</sup> Krstić, Đorđe: „Kolonizacija Južne Srbije“, Shkup, 1928, faqe 5

përkrahësve të tyre, siç kishte të drejtë që ngjashëm të sillet edhe me familjet e internuara dhe të tjerat që shpallehin “armiçësore”.<sup>1652</sup>

Me këtë urdhëresë Beogradi jo vetëm që ndëshkonte militantët e rezistencës kombëtare shqiptare, të cilët edhe më tutje vazhdonin të vepronin në pjesë të caktuara, duke ua marrë pronën, por njëjtë ndëshkonte edhe farefisin e tyre të gjerë, duke i shpallur jatakë. Ndonjëherë në masat ndëshkimore përfshiheshin edhe farefisi i gjerë dhe katundet madje, po qe se ndodhte në të njëjtin vend të vritej ndonjë xhandar apo të sulmohej ndonjë stacion policie apo ushtria.

Njëra ndër masat më të rënda ndëshkimore, megjithatë, mbetej internimi i familjeve të kaçakëve jashtë Kosovës, kryesisht në Serbi. Kështu, pas shpalljes së ligjit të amnistisë të vitit 1921, të cilit iu përgjigj një numër i vogël i kaçakëve, Beogradi do të fillojë zbatimin e kësaj mase ndaj “të padëgjueshmëve”, të cilët pas kalimit të afatit ishin jashtë ligjit. Nga Qarku i Prishtinës, në mars 1921 u internuan në Nish nëna dhe vëllezërit e Ibush dhe Esat Vuçitërnalisë, Bajram Tërnavës iu internuan 5 anëtarë të familjes, Latif Bajramit iu internua gruaja, i biri dhe vëllai i gruas.<sup>1653</sup>

Po më 1921 në kampin e Nishit ishin internuar, sipas qarqeve këto familje:

1. Nga Qarku i Metohisë 21 familje me 74 anëtarë;
2. Nga Qarku i Zveçanit 22 familje me 60 anëtarë;
3. Nga Qarku i Kosovës 16 familje me 81 anëtarë;
4. Nga Qarku i Prizrenit 11 familje me 44 anëtarë;
5. Nga Qarku i Kumanovës 3 familje me 14 anëtarë;
6. Nga Qarku i Tetovës 12 familje me 58 anëtarë;
7. Nga Qarku i Rashës (Tutini, Jeni Pazari) 13 familje me 69 anëtarë;
8. Nga Qarku i Manastirit 6 familje me 20 anëtarë;
9. Nga Qarku i Ohrit 1 familje me 5 anëtarë.<sup>1654</sup>

Se kush duhej të përfshihej në listën “e ngushtë” të kaçakëve apo në atë “të gjerën”, vendosnin organet policore dhe ushtarake si dhe shërbimet e tyre në Shkup. Kështu, sipas pikës 27 të dekretit për kolonizimin e viseve jugore, policia dhe ushtria ishte ajo e cila vendoste për të gjitha çështje që kishin të bënin me pronësinë në brezin kufitar, por edhe në pjesët që nga policia dhe ushtria identifikoheshin “si qendra kaçakësh”, të cilat ishin paraparë për kolonizim, por që kështu mund të pastroheshin nga Shqiptarët. Janë të njohura shumë raste, kur për

---

<sup>1652</sup> Rushiti, Limon: “Lëvizja Kaçake në Kosovë 1918-1928”, Prishtinë, 1981, faqe 158.

<sup>1653</sup> Po aty.

<sup>1654</sup> Po aty, faqe 158.



t'i krijuar rrethanat e volitshme për kolonizim në pjesët e caktuara, paraprakisht inskenoheshin veprimet kaçake me anën e agjentëve të policisë dhe ushtrisë serbe, të cilët shfaqeshin me rroba shqiptare.

Policia dhe ushtria viheshin “në ndjekje “ të “kaçakëve” të maskuar, të cilët, si rëndom iknin, ndërsa policia, duke shpallur në shtyp lajme të rreme, gjoja për vrasjen e policëve ose ushtarëve, ndërmerrnin fushata të gjera pastrimi, ku e pësonin katunde të tëra. Pasi që ato të rrënoheshin, popullatës nuk i mbetej tjetër, pos të shisnin pronat e tyre për pak para dhe të merrnin rrugën e shpërnguljes në Turqi, ose të zhvendoseshin në pjesë të tjera.<sup>1655</sup>

Një ndër inskenimet e tilla të kobshme është edhe ai i katundit Prapashticë, kur pasi që ushtria do të rrënojë katundet me topa në kërkim “të kaçakëve”, si “ndëshkim” do të sjellë 22 familje kolonësh nga Serbia, të cilët do të vendosen në pronat e Shqiptarëve të shpallur “armiç”. Pas dhjetë vitesh, një gjykatë do të shpallë “të padrejtë” dëbimin kolektiv të Shqiptarëve nga kjo pjesë, por kjo do të jetë shumë vonë, meqë shumica e tyre ishin shpërngulur në Turqi.<sup>1656</sup>

Ngjashëm u kolonizuan edhe katundet e tjera në Kosovë (Arilaçë, Kabash, Jabllanicë) duke u mbushur me kolonë nga Krajina, Mali i Zi dhe Dalmacia.

Sipas një statistike të mangët (meqë të dhënat për tokat e kaçakëve si dhe jatakëve të tyre i mbante Ministria e Brendshme dhe Komanda Ushtarake e Zonës III në Shkup), del se sektorit të agrarit në Prizren iu dhanë 295,5 hektarë toke të konfiskuara nga kaçakët. Në Pejë dhe rrethinë (duke përfshirë edhe Gjakovën) fondit agrar iu dhanë 2,761,3 hektarë toke të kaçakëve që iu nda kolonëve nga Mali i Zi. Në pjesën e Llapit dhe të Drenicës kishte rreth 500 hektarë toke të kaçakëve, që u ishte dhënë kolonëve serbë dhe dalmat. Pra, fjala ishte për mbi 4 mijë hektarë tokë të kaçakëve.<sup>1657</sup>

Thuajse në të njëjtën mënyrë është vepruar edhe me tokën e sekuestruar nga shteti “nga shtetasit e huaj”, “armiqtë” e ikur si dhe ata që janë shpërngulur në Turqi gjatë Luftërave Ballkanike, toka e të cilëve u është ndarë kolonëve pa kurrfarë procedure ligjore.

Krahas marrjes së tokave Shqiptarëve në mënyrë të paligjshme dhe me uzurpime, të cilat u jepeshin kolonëve në mënyrë që të shtohet numri i Serbëve në

---

<sup>1655</sup> Më gjerësisht shih: Krstić, Đorđe: “Kolonizacija u Južnoj Srbiji”, Sarajevë, 1928; Lazarević, Tihomir: „Naš kolonizacioni problem“, Srpsko Kosovo, nr. 7, Kosovska Mitrovica, 1921; Novaković, Kosta: „Kolonizacija i srbizacija“, Balkanska federacia, Vjenë, 1931; Albin, Prepeluh: “Agrarna reforma naš veliki problem“, Lubljana, 1933; Davidović, Jaša: „Agrarni problem“, Beograd, 1928.

<sup>1656</sup>Krstić, Đorđe: „Kolonizacija u Južnoj Srbiji“, Sarajevë, 1928, faqe 61.

<sup>1657</sup> Obradović, Milovan: „Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu 1918-1941“, Prishtinë, 1981, faqe 146.

Kosovë, në përputhje me qëndrimet e njohura hegjemoniste serbomëdha të shpallura qysh nga “Naçertanja” e këndeje dhe të proklamuar edhe me rastin e krijimit të Mbretërisë SKS, Beogradi përkujdesej edhe për atë që Kosova të kthehet në një feud të madh kishtar, ku manastiret ortodokse do të bëheshin pronarët kryesorë të tokave. Nga vitit 1922 kishat mesjetare ortodokse, edhe pse ishin pasuri e përbashkët e të krishterëve, ku Shqiptarët që nga shekulli IV e këndeje, pasi që ndër të parët kishin pranuar krishterimin, kishin investuar në to, do të shpallen kisha ortodokse serbe dhe pasuri shpirtërore serbe. Atyre do t’u pranohet tretmani i “pasurisë nacionale”, kështu që manastirit të Graçanicës, atij të Pejës, të Deçanit, Levishkës dhe Shën Arhangjelit në Prizren dhe manastirit të Deviqit në Drenicë, do t’u dhjetëfishohen pronat. Me këtë rast Shqiptarëve iu morën mbi njëmijë hektarë tokë që kishin pranë këtyre kishave.<sup>1658</sup>

Në këtë mënyrë më së shumti tokë morën manastiri i Graçanicës dhe ai i Deçanit, të cilët duhej të ktheheshin edhe në qendra të mëdha të kolonëve serbë dhe malazias. Në pjesën e Graçanicës dhe të Deçanit dëbimi i Shqiptarëve nga tokat e tyre u bë me ndërhyrje policore dhe ushtarake pasi që paraprakisht prej pronarëve të tyre u kërkuan tapitë, që duhej siguruar brenda 48 orësh ose të largoheshin me dhunë. Meqë pak sish kishin tapi, ndërsa të tjerët ishte e pamundur t’i siguronin kur ato lidheshin me administratën osmane, ndërkohë që regjistrat kadastralë dhe të tjera nga koha osmane Mbretëria SKS as që ishte e interesuar t’i kishte, Shqiptarëve u mbetej të largoheshin, ose të strehoheshin nëpër pjesë të ndryshme kodrinore-malore, ku qeveria jepte toka me qira, por me kushte shumë të vështira. Kështu, për ta forcuar elementin serb në rrethin e Graçanicës deri në dhjetor të vitit 1932, nga 11. 391,41 hektarë tokë të punueshme më shumë se gjysma (7 625 hektarë) u ishin dhënë 907 familjeve kolone. 14 familjeve çetnike u ishin dhënë 64,5 hektarë tokë. Po në këtë rreth ishin vendosur edhe 15 familje autokolonë të cilave u ishin dhënë 69 hektarë tokë.<sup>1659</sup>

Me Reformën Agrare bëheshin përpjekje të mëdha që në disa pjesë të banuarra kryesisht me Shqiptarë, siç ishte Gjakova me rrethinë dhe pjesa e Podrimës, të shtohet numri i kolonëve edhe me masa të tjera stimulimi, ku bënin pjesë kreditë, ndërtimi i shtëpive, sigurimi i fondit të bagëtive dhe krijimi i infrastrukturës rru-gore. Deri në vitin 1932 në këtë komunë ishin përgatitur për kolonët 53 mijë hektarë tokë të punueshme nga 77 mijë sa kishte komuna e cila numëronte 43

---

<sup>1658</sup> Shih: Osmani, Jusuf: “Kolonizimi, reforma agrare dhe shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova 1918-1941”, Prishtinë, 2016, faqe 65-68.

<sup>1659</sup> Po aty.

mijë banorë shqiptarë. 17 mijë hektarë tokë të punueshme për kolonët ishin ndarë edhe në Podrimë. Deri në vitin 1932 në komunën e Gjakovës ishin vendosur 2 153 familje kolonësh, të shumtën malazias të cilëve u ishin dhënë 15 613 hektarë tokë. Kurse në rrethin e Podrimës ishin vendosur 24 familje me 235 hektarë tokë. Në rrethinë e Gjakovës qenë vendosur me ndërhyrjen e titullarëve agrarë 23 familje autokolonë, që morën 198 hektarë tokë. Në rrethin e Gjakovës deri në vitin 1932 ishin ndërtuar 1955 shtëpi kolonësh, prej të cilave 560 kishte ndërtuar shteti, ndërsa të tjerat vetë kolonët me ndihmën e kredive dhe ndihmave të tjera të shumta që merrnin nga shteti.<sup>1660</sup>

Edhe në rrethin e Drenicës, ku ishte qendra e lëvizjes kaçake, u bënë përpjekje të mëdha për shpërnguljen e Shqiptarëve dhe për sjelljen e kolonëve. Beograd do të shfrytëzojë gjendjen e nderë që ishte krijuar nga lëvizja kaçake në këto pjesë që të rrënojnë bazën jetësore të familjeve shqiptare, të cilat ndiqeshin në mënyra të ndryshme dhe shumë prej tyre ishin ndaluar me ligj, qoftë pse merrnin pjesë në lëvizjen kaçake, qoftë pse ishin shpallur jatakë të kaçakëve, qoftë pse shumë prej tyre kishin humbur edhe të drejtën e pronës mbi këto baza. Në Drenicë, qendra e së cilës tashmë quhej Serbicë, ishin vendosur 406 familje kolonësh, të cilave iu dhanë mbi tre mijë hektarë tokë ndër më të mirën. 44 familje të kolonëve iu dhanë 330 hektarë tokë. Në këtë pjesë, shteti ndërtoi 414 shtëpi për kolonët, të cilat u pajisën edhe me objektet e tjera përcjellëse: shkolla, ambulanca dhe stacione të policisë. Bazuar në statistikën zyrtare deri në vitin 1939 gjendja e ndërtimit të shtëpive të kolonëve që kalonte 12 mijë sish paraqitej e tillë: Istogu me 1.027 shtëpi, Peja me 1.229 shtëpi, Gjakova me 1.955 shtëpi, Podrimja me 596 shtëpi, Rrethi i Mitrovicës me 85 shtëpi, Deçani me 497 shtëpi, Llapi me 1.307 shtëpi, rrethi i Sharit me 808 shtëpi, Podgori me 73, Graçanica me 1.010 shtëpi, Gjilani me 688 shtëpi, Nerodimja 281 shtëpi, Kaçaniku 64 shtëpi dhe rrethi i Ferizajt bashkë me pjesën e Nerodimës 3.621 shtëpi.<sup>1661</sup>

Të dhënat zyrtare jugosllave bëjnë të ditur se nga viti 1920 deri në vitin 1940 në Kosovë toka u është ndarë 11,714 familjeve kolone, 248 familjeve të vullnetarëve, 80 familjeve çetnike si dhe 508 familjeve kolonëve. Të dhënat bëjnë të ditur se në rrethin e Mitrovicës kolonët morën 4,98 hektar për familje, në Vuçitërnë 7, 29 hektarë për familje, në Deçan 9, 10 hektarë, në Istok 8,9 hektar, në Pejë 8,1 hektarë, në Gjakovë 8,1 hektarë, në Podrimje 12,3 hektarë, në Prizren 9,1 hektarë, në Llap 8,5 hektarë, në Graçanicë 7,9 hektarë, në Kaçanik 8,1 hek-

<sup>1660</sup> Arkivi i Jugosllavisë, S, 96, Kutia. 12/48

<sup>1661</sup> Arkivi i Jugosllavisë, 671-28-263, Raport i Drejtoratit Qendror të Agrarit, nr. 344 , 12 dhjetor 1940.

tarë dhe në Podgor 5,08 hektarë. Në Kosovë, pra një familje kolonësh mori 8,5 hektarë tokë.<sup>1662</sup>

Pra, në Kosovë u vendosën 11,383 familje kolonësh me 53.884 anëtarë. Prej tyre 49,244 Serbë, 5.148 Kroatë dhe 126 Sllovenë. Këto të dhëna nuk janë të pleta, meqë ushtarakët, policët dhe administratorët e lartë e kanë pasur të drejtën për të sjellë kolonë jashtë statistikës zyrtare. Kështu që vlerësohet se ky numër duhej të jetë më i madh edhe për 20%.

Marrë në tërësi reforma agrare si mjet për kolonizimin e Kosovës me Serbë, Malazias dhe të tjerë nuk do t'ia dalë t'i përbushë parashikimet e planifikuesve të saj, të cilët kishin paraparë që gjatë njëzet viteve të ndryshonin strukturën e popullatave në Kosovë në dëm të asaj shqiptare, e cila, nga 86% sa ishte gjatë Luftërave Ballkanike, duhej të zbriste në rreth 30%, ndërsa popullata sllave (serbe dhe malaziasë) të rritej nga 8 % sa ishte në vitin 1912 në 60%. Pra, matematikisht për t'u arritur kjo do të duhej që nga Kosova të shpërnguleshin dhunshëm dhe me metoda të tjera rreth 400 mijë Shqiptarë, ndërsa të vinin rreth 300 mijë kolonë. Por, nëse Beogradi përkundër të gjitha kushteve aq të favorshme që u kishte ofruar Serbëve për të kolonizuar Kosovën nuk ia kishte dalë të sillte më shumë se 60 mijë sish, pra kishte përbushur vetëm një të pestën e parashikimit, megjithatë, ia kishte dalë që, në forma të ndryshme, të dëbonte përgjithmonë mbi 200 mijë Shqiptarë, ose një të tretën e tyre.<sup>1663</sup>

Ky, gjithsesi, ishte një sukses i madh për Beogradin, që ishte arritur në radhë të parë me mjetet ushtarake-policore kundër popullatës shqiptare, por edhe me mjetet e tjera, siç ishte diskriminimi me rastin e reformës agrare, kur atyre u

---

<sup>1662</sup> Po aty.

<sup>1663</sup> Rreth numrit të saktë të shqiptarëve të shpërngulur nga viti 1913 deri më 1941 në Turqi, Shqipëri ose vendet e tjera nuk ekzistojnë të dhëna të sakta, në arkivat jugosllave, në ato të Shqipërisë, e as në ato turke. Burime të ndryshme spekulojnë me numrin nga 200 mijë deri në 400 mijë. Shqipëria madje, nuk disponon as me të dhënat rreth strehimit të përkohshëm apo të përhershëm të shqiptarëve që do të gjejnë strehim atje gjatë luftërave ballkanike dhe më vonë, për faktin e thjeshtë se shteti shqiptar do të fillojë të krijojë arkivin shtetëror nga mesi i dytë i viteve të njëzeta, por pa i përfshirë të dhënat që do ta plotësonin disi këtë problematikë. Mbretëria Jugosllave është arsyetuar se përkundër konventës me Turqinë të vitit 1938, e cila nuk është ratifikuar dhe si e tillë nuk ka hyrë në fuqi, nuk ka pasur shpërngulje zyrtare për në Turqi, por pranon se diçka e tillë është zhvilluar nëpërmjet kanaleve ilegale, që është mundësuar me anën e sistemit të vizave të përkohshme që ka shpërndarë konsullata turke në Shkup. Me këtë rast është thënë se bëhej fjalë për popullatë myslimane që është ndjerë turke. Jugosllavia e Titos pranon se midis viteve të pesëdhjeta dhe atyre të gjashtëdhjeta, konform marrëveshjes me Turqinë, është bërë një shpërngulje e popullatës turke për në Turqi, të shumtën nga Maqedonia, edhe nga Kosova, Sanxhaku, por edhe nga Bosnja, pa u dhënë asnjëherë numri i saktë i të shpërngulurve. I vetmi burim meritë, që do të mund të hidhte dritë në këtë çështje janë arkivat e Turqisë, por edhe ato, flasin vetëm për "riatdhësim" të popullatës turke dhe myslimane pa dhënë shënime për përkatësinë kombëtare të të shpërngulurve. Jozyrisht në Turqi pranohet se nga Kongresi i Berlinit e deri në vitet e pesëdhjeta të shekullit të kaluar, nga Ballkani janë "riatdhësuar" rreth dy milionë turq.

uzurpoheshin pronat, ndërkohë që privoheshin nga të gjitha mundësitë që të fitonin të drejtën e pronësisë që e kishin gjatë Perandorisë Osmane ose që do të duhej ta fitonin me rrënimin e rendit feudal, kur çifçinj të e deridjeshëm fitonin të drejtën e tokës që kishin punuar. Kështu, e ndjekur dhe e diskriminuar, e privuar nga e drejta e pronës, por edhe e përjashtuar prej saj pse do të rezistojë kundër terrorit shtetëror (siç ishte rasti me lëvizjen kaçake, e cila ka merita të mëdha për frenimin e procesit të kolonizimit të Kosovës në përputhje me synimet e Beogradit), një pjesë e mirë e popullatës shqiptare, do të kërkojë të largohet nga Kosova në Turqi, në mënyrë që atje të gjejë shpëtim, por edhe perspektivë.

Shpërngulja e Shqiptarëve nga trojet e tyre etnike si dhe kolonizimi i saj me Serbë dhe Malazias ishte pjesë e programit nacional serb. Zbatimi i këtij projekti duhej të fillonte nga Luftërat Ballkanike, ku për Beogradin lufta kundër mbetjeve të fundit të Perandorisë Osmane në tokat shqiptare duhej të kthehej në një luftë “çlirimtare” për “rikthimin e Serbisë së vjetër”. Ajo duhej të drejtohej kryekrejt kundër popullatës shqiptare dhe qenies së saj ekzistenciale. Si do të shihet, gjatë Luftës së Parë Ballkanike, do të vihen në veprim projektuesit dhe zbatuesit e këtij skenari. Ata ishin ushtarakët e armatës serbe dhe malazias, si dhe shërbimet përcjellëse, që luftën për ndjekjen e forcave osmane do ta kthejnë në një luftë kundër popullit shqiptar, siç ishte vepruar edhe në luftën e vitit 1877/78 me rastin e depërtimit të ushtrisë serbe në krahinën e Toplicës kur gjatë operacionit ushtarak të atij dimri ishin bërë rrafsh me tokë mbi 400 katunde dhe vendbanime të Shqiptarëve në këto pjesë, me ç’rast ishte bërë largimi plotë i kësaj popullate prej andej.<sup>1664</sup>

Edhe depërtimi dhe pushtimi i viseve shqiptare gjatë Luftës së Parë Ballkanike në vjeshtën dhe dimrin e vitit 1912/13 ishte bërë thujtë me të njëjtin skenar. Ushtritë serbe dhe malazias, njëra nga veriu dhe tjetra në tri drejtime (nga lugina e Ibrit, Nishi dhe lugina e Vardarit) në shënjestër kishin pasur popullatën e pambrojtur shqiptare, e cila gjatë depërtimit të këtyre ushtrive, për t’i ikur masakrës së tmerrshme, kishte marrë ikën në dy drejtime: kah Shqipëria dhe kah Turqia. Që të dy këto drejtime ishin udhëhequr nga ushtarakët dhe strategjia e përcaktuar që më parë që pushtimi të përcillet me dëbimin masiv të popullatës shqiptare në këto drejtime.<sup>1665</sup>

---

<sup>1664</sup> Më gjerësisht rreth veprimeve luftarake kundër popullatës shqiptare gjatë luftës serbo-turke të vitit 1877/78 dhe asaj ruso-turke të vitit 1878 shih Buxhovi, Jusuf: “Kongresi i Berlinit dhe Lidhja shqiptare 1878”, Prishtinë 2012; “Nga Shqipëria Osmane te Shqipëria Europiane”, Prishtinë 2010; “Historia e Popullit Shqiptar”, II, Tiranë 2002; Frashëri, Kristo: “Lidhja shqiptare e Prizrenit 1878-1881”, Tiranë 2012.

<sup>1665</sup> Rreth gjenocidit ndaj shqiptarëve shih: “A Trail of Blood”, “New Yor Times”, 31 dhjetor 1912; Freundli, L.: “Golgota e Ballkanit”; Tucović, D.: “Srbija i Arbanija”, Beograd 1914.

Kështu, sipas të dhënave të mbledhura, krahas vrasjeve, pushkatimeve në masë nga ushtritë serbe dhe malaziasë gjatë operacioneve luftarake, ku kishin gjetur vdekjen mbi 30 mijë veta, rreth njëqind mijë Shqiptarë kishin kaluar në Shqipëri si refugjatë, ndërsa mbi pesëdhjetë mijë ia kishin dalë të ndiqnin tërheqjen e ushtrisë osmane në drejtim të Turqisë. Shumica e tyre kishin shkuar nëpër Maqedoni në Selanik dhe prej andej për në Turqi. Pjesa më e madhe e atyre që kishte tentuar të kalonte nëpër Bullgari për në Turqi nëpër Sofje (vlerësohet mbi 20 mijë veta), nuk ia kishin dalë ta bënë këtë. Shumë prej tyre, kishin vdekur rrugëve, ndërsa një pjesë e vogël ishte marrë në mbrojtje nga Kolonia Shqiptare në Sofje dhe prej andej pastaj, një pjesë e atyre kishin mbijetuar disi, me anën e shoqatave humanitare dhe fetare, ishin përcjellë në Turqi.

Ky kalvar, i cili nuk kishte mbetur i pavërejtur dhe i pagjykuar edhe nga opinionieuropian, por edhe nga vetë socialdemokracia serbe, do të vazhdojë edhe pasi që Konferenca e Ambasadorëve në Londër të marrë vendimet që viset e pushtuara nga ushtria serbe dhe malaziasë t'u pranohen këtyre shteteve.<sup>1666</sup> Madje, nga fundi i vitit 1913 e deri në gusht të vitit 1914 kur do të fillojë Lufta e Parë Botërore, këto dy vende, në mënyrë sistematike përdorën mjetet e terrorit shtetëror, në radhë të parë ato ushtarake dhe policore, për të vazhduar gjenocidin ndaj Shqiptarëve. Janë të njohura veprimet e Beogradit dhe të Cetinës, që të provokohet popullata shqiptare në mënyrat më të pashembullta, që ajo të reagojë, të kundërshtojë. Ashtu do të reagojë popullsia e Dibrës dhe e Dukagjinit gjatë vjeshtës dhe dimrit të vitit 1913 kur do të përfshihet në një kryengritje të gjerë, që do të përfundojë me pasoja tragjike. Ushtria serbe këtë do ta shpallë “lëvizje separatiste”, ndaj të cilës, për ta shuar, mori masa tejet të ashpra. Ngjashëm do të vepron edhe në pjesët e tjera të Kosovës, kur edhe ndaj rezistencës më të vogël të Shqiptarëve kundër pushtetit okupues, pasonte kundërpërgjigja ushtarake, e cila drejtohej kundër popullatës së pambrojtur dhe katundeve të tyre, që rrënoheshin.

Ndër këto provokime të rënda gjithsesi ishin aksionet për çarmatim, ato për mobilizim dhe veçmas, poshtërimi i objekteve fetare, kur ato rrënoheshin, por edhe ktheheshin në depo, stalla kuajsh për suharinë e ushtrisë dhe të xhandarmërisë. Madje, sipas një shënimi, Komanda e Armatës së Tretë kishte proklamuar se edhe më tutje do të mbajë që të gjitha xhamitë dhe mejtepet për qëllime luftarake.<sup>1667</sup>

---

<sup>1666</sup> Më gjerësisht: Kosta Novaković: “*Nacionalizacija i srbizacija Kosova*”, “La federalitione balcanique”, Vjenë 1931, pastaj raportet e gazetave “*Proleter*”, “*Rad*”, “*Socialistička zora*”, “*Pravda*”, “*Hak*”, e të tjera gjatë nëntorit-dhjetorit 1912 dhe janar-qershor 1913.

<sup>1667</sup> Arhiv Jugosllavije (Arkivi i Jugosllavisë), shënimin 63, kutia 135, dokumentet: 471, 148, 27 dhe 28.

Duke ditur rrethanat shoqërore si dhe traditën e Shqiptarëve, ushtria serbe dhe ajo malaziase stacionohej nëpër katunde duke vendosur dhunshëm shtabet nëpër kullat e caktuara të Shqiptarëve, të cilat i zgjidhte dhe prej tyre largonte pronarët e tyre. Pos këtyre veprimet tepër arbitrare, që për pasojë kishin largimin përgjithmonë të pronarëve prej tyre, ose kundërvënien (gjë që dihej si përfundonte), autoritetet ushtarake serbe, gjithnjë sipas udhëzimeve të marra për ta nënçmuar dhe fyer popullatën e pambrojtur shqiptare, shumë prej tyre i vente në shërbim angarie të ushtrisë, ndërkohë që vazhdonte bastisjes e familjeve të mëdha, duke mos ngurruar që krahas burgosjeve të poshtëronte të rinjtë dhe burrat para grave dhe fëmijëve.

## SHPËRNGULJA E SHQIPTARËVE PËR NË TURQI

Pas Luftës së Parë Botërore, me formimin e Mbretërisë Serbe-Kroate-Sllavene, me shpalljen e reformës agrare në gusht të vitit 1920, rifilloi procesi i kolonizimit të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare të mbetura në kufijtë e Mbretërisë Jugosllave. Në vitet 1919-1941, borgjezia serbomadhe shfrytëzoi shtetin jugosllav dhe gjithë potencialin e tij të madh për të arritur qëllimin antishqiptar. Reforma Agrare si mjet i kolonizimit, do të përcillet me shumë forma të tjera të diskriminimit të hapur nacional me anën e të cilave do të duhej të thyhej, por edhe të copëtohej sa më tepër që të ishte e mundur etnia shqiptare deri te përmasat e vendosjes së një raporti të ri që do të ishte në dobi të popullsisë sllave.

Kjo çështje ishte i studiuar mirë dhe atunë kryesore e kishte te shpërngulja e dhunshme e Shqiptarëve në Turqi dhe gjetiu, ku në njërin anë do të shfrytëzohej rezistenca e armatosur e Shqiptarëve në luftë për mbrojtjen e trojeve të tyre si përgjigje e natyrshme ndaj gjendjes së pushtimit, dhe në tjetrën do të jenë masat e diskriminimit të hapur ekonomik, nacional dhe politik të Shqiptarëve në të gjitha fushat e jetës, në mënyrë që atyre t'u krijohet përshtypja se janë të huaj dhe armiq të shtetit sllav, ndërkohë që ardhmërinë duhej ta kërkojnë gjetiu: në Shqipëri ose në Turqi.

Në përputhje me këtë kemi masat ushtarake-policore si dhe ato të natyrës ekonomike dhe politike. Këto duhej të prodhonin pakënaqësinë, dëshpërimin dhe dorëzimin e Shqiptarëve. Ndërsa aty ku shfaqej revolta dhe rezistenca deri te ajo e armatosura, siç ishte rasti me lëvizjen kaçake, atëherë ajo duhej shfrytëzuar për dhunë shtetërore që Shqiptarëve t'u rrënohej qenia ekzistenciale, gjë që me këtë

arriheshin dy qëllime: ai i zhvendosjes së dhunshme të tyre dhe shpërnguljen nga trojet e tyre dhe njëherësh i krijimit të hapësirave të përshtatshme për vendosjen e kolonëve në pronat dhe shtëpitë e Shqiptarëve të rebeluar dhe atyre që shpallshin armiq të shtetit pse rezistonin terrorin shtetëror.

Natyrisht, kjo sjellje do të krijojë rrethana reale për një shpërngulje sa më të madhe të Shqiptarëve në Turqi, ose ikjen e tyre në Shqipëri.

Pas Luftës së Parë Botërore, nga pamundësia që lufta dhe mjetet e saj të shfrytëzoheshin për shpërngulje masive të popullatës, siç ishte vepruar gjatë Luftës së Parë Ballkanike dhe operacioneve që kishin vazhduar edhe për një vit, procesi i shpërnguljes në Turqi, të shumtën do të kthehet në një veprim klandestin. Në të do të përzihen faktorë të ndryshëm, nga shërbimet policore-ushtarake jugosllave, spekulantët, kriminelët dhe përfitues të ndryshëm, në formë të një rrjeti të tërë. Edhe pse mund të thuhet se nga viti 1924, pasi që do të shpallet Republika e Turqisë me në krye Kemal Atatürkun (Mustafa Qemalin, me prejardhje shqiptare), ky proces, paksa do të ndalet, ai do të vazhdojë edhe më tutje duke marrë përmasa gjithnjë e më të mëdha. Kësaj do t'i kontribuojë edhe vete shteti turk, duke lidhë marrëveshje shtetërore me Beogradin për shpërnguljen e popullatës “turke” për në Turqi.

Se çfarë ishin manipulimet me refugjatët si dhe dërgimin e tyre në Turqi me anën e kanaleve klandestine këtë më së miri e përshkruan gazeta “*Hak*”, e cila bën të ditur për lidhjet e shërbimeve policore jugosllave me konsullatën turke në Shkup si dhe kapitenin e anijes “*Turan*” në Selanik, e cila fuste emigrantët shqiptarë midis emigrantëve grekë që dërgoheshin në Turqi në saje të marrëveshjes shtetërore turko-greke për shkëmbimin e popullatës. Kjo gazetë njofton se refugjatët e shkretë duhej të paguanin taksa shtesë për t'u futur në anije, prej nga pastaj hidheshin në ndonjë liman turk pa dokumente.<sup>1668</sup>

Krahas kësaj, qeveria jugosllave ia kishte dalë që një numër të mirë të tëshpërngulurve shqiptarë t'i fuste në listat e muhaxhirëve bullgarë, nga pastaj shkonin në Turqi. Me një kontingjent të tillë ishin dërguar 240 familje shqiptare nga Prizreni, Gjakova dhe Peja, të cilat, pa dokumente, kishin mbetur rrugëve të Stambollit.<sup>1669</sup>

Që shpërngulja të përfshinte “popullatën turke e cila kishte të drejtë të shkonte në shtetin amë”, qeveria e Beogradit dhe ajo turke, në vitin 1926, do të arrijnë të projektojnë një marrëveshje për shpërnguljen e 300-400 mijë vetash, kryesisht

<sup>1668</sup> Gazeta “*Hak*”, 30 janar 1924 dhe 13 shkurt 1924.

<sup>1669</sup> Shih DASIP: dokumentin e Arkivit Shtetëror të Sekretariatit të Punëve të Jashtme të Mbretërisë SKS, 831, faqe 7.



Shqiptarë, të cilët midis dy vendeve cilësoheshin “turq”. Ky projekt, së paku që të mos marrë mbështetjen zyrtare, që do ta marrë pak më vonë, u ndal për pak në saje të shkrimit të gazetës “Haqimijeti Milijet” dhe “Milijet” të prillit të vitit 1927, por kjo nuk ndaloj kanalet klandestine që të vazhdojnë edhe më tutje depërtimi ne Shqiptarëve në Turqi. Rreth kësaj prefekti i Qarkut të Zveçanit i shkruante mbretit gjithë mburrje se “deri sa isha prefekt nga regjioni im prej vitit 1924 deri më 1927 janë shpërngulur 32 mijë Shqiptarë për në Azi, Shqiptarë të rrezikshëm për vendin tonë, ndërsa pronat i kanë marrë Malaziasit.”<sup>1670</sup>

Në të njëjtin raport bëhet fjalë edhe për shpërnguljen e 6.000 Shqiptarëve të tjerë që shkuan në Shqipëri. Jo zyrtarisht thuhet se nga viti 1918 deri më 1929, në forma të ndryshme, në Turqi ishin shpërngulur rreth 130 mijë Shqiptarë. Edhe pse kjo shifër nuk mund të konfirmohet nga burime meritore, meqë shumë prej atyre që kishin shkuar në Turqi kishin kaluar nëpër kanale klandestine, ndërkohë që në mungesë të dokumenteve personale, organet zyrtare turke i kishin shënuar si refugjatë lufte, megjithatë numri i të shpërngulurve nga Kosova dhe viset e tjera kalonte njëqindmijë. Në këtë ndërkohë, po ashtu, kemi edhe shpërnguljen e 3.126 familjeve shqiptare në Shqipëri, të cilat, të shumtën do të kalojnë kufirin në pjesën veriore. Në të vërtetë ky kalim i kufirit nuk do të ndalet asnjëherë, sepse Mbretëria SKS kishte krijuar kanalet e përhershme të dëbimit të Shqiptarëve nga pjesët e Dukagjinit në Shqipëri. Metodrat ishin fare “të thjeshta”: pas veprimeve të kaçakëve, kur ata vrisnin ndonjë xhandar apo zyrtar serb, atëherë fillonin bastisjet, burgosjet dhe ndjekjet e popullatës, të cilat në ikje e sipër drejtoheshin kah Shqipëria. Në afërsi të kufirit ndihmoheshin nga ushtria dhe personat e tjerë për t’u hedhur përtej kufijve. Për të tjerat nuk çante kokën Beogradi.<sup>1671</sup>

Meqë shteti turk kishte arritur marrëveshje me Rumaninë dhe Bullgarinë për shpërnguljen e Turqve në Turqi dhe të njëjtën e kishte arritur edhe me Greqinë, edhe Jugosllavia hapi çështjen e shpërnguljes së “popullatës turke” në Turqi. Për këtë u shfrytëzua mbledhja e Këshillit Ballkanik, në Ankara më 25-27 shkurt të vitit 1938. Me këtë rast, ministri i punëve të jashtme i Turqisë, Ruzhdi Arasi, parashtroi çështjen e shpërnguljes së “turqve” nga Ballkani dhe propozoi që të formohet një komision i përbërë prej dy Rumunëve, dy Jugosllavëve dhe dy Turqve që në prill të vitit 1938 të mblidhet komisioni dhe të fillojë punën ekskluzivisht rreth shpërnguljes së Shqiptarëve nga Kosova.<sup>1672</sup>

---

<sup>1670</sup> Po aty, dokumenti 15.

<sup>1671</sup> Po aty.

<sup>1672</sup> Shih: Dokumentet e Arkivit Shtetëror të Jugosllavisë DASIP, DNŽ, faqe 15, dok.1 dhe faqe 9, dok. 4.

Bëhet e ditur se katër konferencat ndërministrrore qenë mbajtur në Beograd, nga fillimi i marsit deri në mesin e qershorit të atij viti. Qeveria jugosllave ngulte këmbë që përparësi për t'u shpërngulur duhej të kishte popullata nga katundet e Kosovës, në mënyrë që pastaj të lirohej hapësira për kolonizim.<sup>1673</sup>

Pas shumë e shumë shqyrtimelesh rreth numrit të të shpërngulurve si dhe dinamikës së realizimit të saj, që vendosur edhe për dëmshpërblimin që Turqia duhej të merrte nga Jugosllavia. Sipas kësaj marrëveshje Jugosllavia do t'i paguante Turqisë dëmshpërblimin maksimal prej 15 mijë dinarësh për një familje, përkatësisht 2-5 mijë dinarë për një anëtar, dhe prej këtij kompensimi 20% duhej t'i paguhej Turqisë në deviza të lira, ndërsa 80% do të qitej në xhiro-llogarinë e Bankës Popullore të Qeverisë Turke për sigurimin e mallit në Jugosllavi.<sup>1674</sup>

Marrëveshja midis Qeverisë së Turqisë dhe Qeverisë së Jugosllavisë u lidh më 11 korrik 1938. Në këtë dokument tepër sekret jepen të dhënat se çfarë qëllimi ka pasur Konventa. Në të theksohet se prej Jugosllavisë do të shpërngulen në Turqi 40 mijë familje myslimane, prej territoreve që Serbia dhe Mali i Zi i aneksuan më 1912 dhe 1913. Shpërngulja, thuhet në Konventë, do të bëhet për 6 vjet, me kusht që mund të vazhdohet edhe për një vit prej afatit të caktuar. Jugosllavia do t'i paguajë Turqisë për çdo familje të shpërngulur nga 500 lira turke, prej të cilave 30% në deviza, ndërsa pjesa tjetër, 70% të deponohet në Bankën Popullore, në llogarinë e Qeverisë Turke. Me të hollat e deponuara, Qeveria Turke, mund të blinte mall në tregun jugosllav.<sup>1675</sup>

Sipas nenit 12 të Konventës, personat që do të evakuhohen gjatë periudhës së shpërnguljes, të cilët do të shpërngulen sipas listës vjetore, duhet të japin (paraqesin) deklaratë me shkrim para autoriteteve jugosllave në bazë të nenit 53 të Ligjit mbi shtetasit jugosllavë që është në fuqi, se heqin dorë me dëshirë nga shtetësia jugosllav. Këta persona do t'i kenë cilësitë dhe do t'i gëzojnë të drejtat e të shpërngulurve sipas ligjeve turke, që nga momenti kur përfaqësuesit e Turqisë, të cilët do të emërohen për këtë çështje, do t'i nënshkruajnë listat vjetore të emigrimit në Turqi.

Sipas Konventës, muhaxhirët e shpërngulur me dhunë, kishin të drejtë të marrin një pjesë të bagëtisë dhe të shfrytëzojnë hekurudhën deri në Selanik, prej nga pastaj shpenzimet e tjera i merrte përsipër qeveria turke.

---

<sup>1673</sup> Bajrami, Hakif: *"Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë më 1918-1941"*, Prishtinë, 1981, faqe 159 dhe Osmani, Jusuf: *"Kolonizimi, reforma agrare dhe shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova 1918-1941"*, I,II,III, Prishtinë, 2016.

<sup>1674</sup> Shih: Dokumentet e Arkivit Shtetëror të Jugosllavisë DASIP, DNŽ, faqe 15, dok.1; AVII. P. Kutia 95 a, faqe 2. Dok.1.

<sup>1675</sup> Bajrami, Hakif: *"Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë më 1918-1941"*, Prishtinë, 1981, faqe 160.

Shpërngulja parashihte këtë dinamikë: më një korrik 1939 do të shpërnguleshin 4000 familje; më 1940 - 6 000 familje; më 1941 - 7 000 familje; më 1942 - 7 000 familje; më 1943 - 8 000 familje; më 1944 do të shpërnguleshin 8 000 mijë familje.

Regjionet, të cilat i nënshtrohen emigrimit sipas kësaj Konvente, janë:

*1. Rajoni i Banovinës së Vardarit:*

Rajoni i Malit Sharr (Prizreni); Gora (Dragashi); Podgora (SuhaReka); Nerodimja (Ferizaj); DonjiPollog-Pollogu i Ulët (Tetova); GornjiPollog-Po-llogu i Sipërm (Gostivari); Galica (Rostusha); Dibra (Dibër); Struga (Strugë); Graçanica (Prishtinë); Kaçaniku (Kaçanik); Gjilani (Gjilan); Presheva (Preshevë); Prespa (Resnja); Poreçi (JuzhniBrod-MakedonskiBrod); Prilepi (Prilep); Bitoli (Manastiri); Kavadarci (Kavadari); Marihovo (Manastiri-Marihovë); Negotin Na Vardaru (Negotini i Vardarit); Skopje (Shkupi), Kumanova (Kumanovë); Velesi (Velesi); Ovçe Pole (Ovçe Pole); Radovishte (Radovishte); Strumica (Strumicë); Dojrani (Valandova); Gjevgjelija (Gjevgjelija); KrivaPallanka (KrivaPallanka); Kratovo (Kratova); CarevoSello (CarevoSello); Malesi (Berovo).

*2. Rajoni i Banovinës së Zetës, përfshin:*

Pejën (Pejë); Istokun (Istog); Mitrovicën e Kosovës (Mitrovicë e Kosovës); Gjakovën (Gjakovë); Podrimjen (Rahovec).

*3. Rajoni i Banovinës së Moravës përfshin:*

Llapin (Podujevë); Vuçiternën; Drenicën (Sërbicë).

Qeveria jugosllave do të caktonte se nga cili regjion do të fillonte emigrimi (shpërngulja).

Qeveria turke kishte kërkuar nënshkrimin e menjëhershëm të Konventës në Beograd ose Ankara. Preferohej që ajo të mos publikohej për shkak të rrethanave të jashtme dhe të brendshme politike. Preferohej që ajo të vihet në jetë si urdhëresë e qeverisë dhe të përliqet me Ligjin Financiar pasues të Mbretërisë Jugosllave.<sup>1676</sup>

## PROGRAMET ANTISHQIPTARE TË AKADEMIKËVE SERBË DHE MEMORANDUMI I ÇUBRILLOVIQIT I VITIT 1937

Për ndryshim prej politikave nacionaliste të shekullit nëntëmbëdhjetë, të cilat, te popujt sllavo-ortodoks të Ballkanit, mbështeten në ideologjinë ekspansioniste, nacionalizmi serb projektoi “Serbinë e Madhe”, mbi platformën e një he-

---

<sup>1676</sup> Po aty, faqe 160.

gjemonizmi ekstrem, që për t'i sendërtuar synimet e veta pushtuese parashihte programet për pastrimet etnike. Ato duhej të bëheshin me metoda të ndryshme nga ato të shfrytëzimit të luftërave “çlirimtare” me Perandorinë Osmane e deri te përdorimi i dhunës shtetërore në emër “të rregullit dhe të ligjit”. Ende pa u bërë shtet, në rrethanat e një pashallëku autonom siç ishte ai i Beogradit në vitet e dyzeta të shekullit nëntëmbëdhjetë, politikani dhe diplomati serb, Ilija Garashanin, në vitin 1844 doli me “*Naçertanjen*”, në të cilën shteti i ardhshëm serb projektohej në një hapësirë për dy apo tri herë më të madhe nga ç’ishin përmasat reale të shtrirjes etnike të Serbëve.<sup>1677</sup>

Krahas shtrirjes në pjesët perëndimore (Bosnje dhe Hercegovinë dhe Dalmaci), ku Sllavët kishin krijuar “bërthamën” nga dyndja e tyre në Ilirik e tutje, pjesa tjetër kishte të bënte me hapësirën etnike shqiptare (Vilajeti i Kosovës, i Shkodrës dhe i Manastirit) pa përjashtuar edhe atë të Selanikut, ku Sllavo-Maqedonasit ishin në shumicë. Kështu, nëpërmes hapësirës shqiptare Serbia planifikonte të dilte në dy dete: në Adriatik dhe Egje. Për ideologun e nacionalizmit dhe hegjemonizmit serbomadhi Serbia “e natyrshme” arsyetohej me “të drejtën mesjetare historike” të serbëve, edhe pse kjo “e drejtë”, jashtë çdo realiteti, ishte vetëm një konstrukt i ndërtuar mbi mitin e Kosovës, që duhej të sendërtohej me të gjitha mjetet, pa përjashtuar edhe ato të luftës, të cilave Serbia do t’u mbetet besnike deri në kohën tonë.

Kështu, gjatë Luftës serbo-osmane të vitit 1876/7, Serbia depërtimet e saj të para do t’i bëjë, duke u zgjeruar në drejtim nga Nishi deri në Kurshumli nëpërmes pushtimeve, të shumtën në kurriz të etnisë shqiptare. Edhe pse këtë luftë do ta humbë nga Turqia, ushtria serbe, në mënyrë të sofistikuar sulmoi vendbanimet shqiptare, të cilat do t’i rrënojë, prej nga një pjesë e madhe e popullatës u detyrua të largohet. Ishte ky paralajmërim për një sjellje morbide, të cilën Serbia do ta vejë në veprim pas një viti kur do ta shfrytëzojë luftën ruse-osmane dhe disfatën e Perandorisë Osmane për të njëjtat qëllime, por këtë herë me pasoja fatale për Shqiptarët, meqë gjatë këtij depërtimi, ushtria serbe pastroi Toplicën nga popullsia e gjithëmbarshe joserbe e kësaj pjese. Me këtë rast, krahas terrorit të paparë të ushtruar ndaj popullatës së pambrojtur (vlerësohet se kishte mbi dhjetë mijë shqiptarë të vrarë dhe mbi pesëdhjetë mijë të tjerë të shpërngulur në Kosovë dhe Turqi), do të rrënohen me tokë mbi 400 vendbanime shqiptare. Këto territore, bashkë me disa të tjera, Paqja e “Shën Stefanit” e marsit 1878, ia njohu Serbisë,

---

<sup>1677</sup> Shih tekstin e plotë (dokument) të “Naçertanajës” së Garashaninit te Verli, Marengelen: “*Kosova sfida shqiptare në historinë e një shekulli*”, Tiranë 2007, faqe 29-43.

ndërkohë që shumë prej tyre ia pranoi edhe Kongresi i Berlinit i qershorit të atij viti, me ç'rast Serbia si shtet i pavarur doli me një hapësirë 60% më të madh nga ç'e kishte si pashallëk autonom (i Beogradit), hapësirë kjo që deri më atëherë ishte të shumtën i banuar me Shqiptarë dhe kjo madje pranohet edhe prej burimeve serbe. Sipas këtyre burimeve, principata serbe (Pashallëku i Beogradit) në vitin 1875, me 37 mijë kilometra katrore hapësirë, kishte 1,3 milionë banorë, prej tyre 59% Serbë, rreth 20% Vllehë, ndërsa rreth 30 % popullatë myslimane, shumica e të cilës ishte Shqiptare. E gjithë krahina e Toplicës (nga Prokupja dhe Kurshumli me një sipërfaqe prej afro 8 mijë kilometra katrore), e cila një vit më vonë, gjatë Luftës Serbo-Ruse do të pushtohet nga ushtria serbe, ishte kryesisht e banuar me Shqiptarë.<sup>1678</sup>

Gjatë asaj lufte dhe pas rikthimit të ushtrisë serbe në dimrin e vitit 1878 në ato vise, ajo do të pastrohet nga elementi shqiptar, ndërkohë që pos njëmbëdhjetë mija të vrrarëve dhe të zhdukurve, për në Kosovë dhe Turqi do të shpërngulën mbi njëqind mijë veta.<sup>1679</sup>

E trimëruar nga peshqeshet që ia solli Kongresi i Berlinit, Serbia planifikoi hapin tjetër për të pushtuar pjesën më të madhe të viseve shqiptare, në mënyrë që në bashkëpunim me aleatët e saj (Greqinë, Malin e Zi dhe Bullgarinë) njëherë e përgjithmonë t'i japë fund çështjes shqiptare me anën e copëtimit të etnisë së tyre në katër pjesë, i cili duhej të përcillej edhe me pastrimin etnik të saj nga Shqiptarët.

Edhe ky hap duhej të bëhej me anën e luftës, por këtë herë me atë "çlirimtare" kundër Perandorisë Osmane, e cila përfundimisht duhej të largohej nga hapësiraeuropiane. Duke parë se Shqiptarët nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe veçmas nga Revolucioni Xhonturk, në saje të programeve kombëtare që parashihnin një shtet autonom shqiptar brenda Perandorisë Osmane po faktorizohehin, do të shfrytëzohet marrëveshja e Hasan Prishtinës me Ibrahim Pashën me të cilën po krijoheshin rrethanat për të ashtuquajturën Shqipëri Osmane, që të hyhet në luftë me Perandorinë Osmane.

Pra, Lufta e Parë Ballkanike e vjeshtës së vitit 1912, nuk ishte gjithaq për "t'u çliruar" nga Perandoria Osmane, sa për t'u penguar projekti i krijimit të Shqipërisë Osmane, e cila një ditë do të kthej në Shqipëri Europiane.

---

<sup>1678</sup> Më gjerësisht rreth shtrirjes etnike të shqiptarëve në krahinën e Toplicës si dhe pasqyrën etnike në Pashallëkun e Beogradit dhe në pjesë të tjera të Serbisë në prag të Kongresit të Berlinit shih këto burime serbe: Jagodić, Miloš: „Naselevanje kneževine Srbije 1861-1880“, Beograd, 2004; Protić, Stojan (Balkanicus): „Albanski problem i Srbija i Ausgro-Ugarska“, Beograd, 1913.

<sup>1679</sup> Shih Buxhovi, Jusuf: „Kongresi i Berlinit dhe Lidhja shqiptare e 1878“, Prishtinë 2012; Čubrilović, Vasa: „Iselevanje Arnauta“, Srpski Kulturni Klub, Beograd, 1937, botuar në „Delo“, Lubljana, 1986.

Në të vërtetë, kjo luftë, ishte hegjemoniste në njërin anë dhe pushtuese në tjetrën anë: hegjemoniste pse ajo nuk kishte të bënte me “çlirime nacionale” - meqë të katër shtetet qysh moti kishin arritur dhe tejkaluar përmasat e hapësirave etnike të shumtën në dëm të Shqiptarëve dhe etnisë së tyre - ndërsa pushtuese sepse pas largimit të osmanëve Shqiptarët i vente nën një zgjedhë tjetër pushtuese, me anën e të cilës ata kërcënoheshin deri në zhdukje fizike.

Se do të ndiqej ky skenar, kjo tashmë hetohej nga traktatet e “fshehta” por edhe të hapura që shtetet e Ballkanit (Serbia, Mali i Zi, Greqia dhe Bullgaria) kishin lidhur në fillim të vitit 1912 e deri në qershor të atij viti me njëra-tjetrën ose bashkërisht për ta ndarë mes vete hapësirën shqiptare, por se do të veprime në këtë frymë, do të shihet sapo të fillojë lufta e tyre kundër Perandorisë Osmane, në tetor të atij viti vetëm një muaj e ca pasi që Hasan Prishtina në Shkup të ketë nënshkruar marrëveshjen me Ibrahim Pashën me anën e së cilës i hapeshin dyert krijimit të Shqipërisë Osmane si një faktor i ri në Ballkan, mbi të cilin do të ndërtoheshin sferat e reja të interesit të Fuqive të Mëdha.

Ushtritë e fqinjëve të Shqiptarëve, në radhë të parë ato malaziasë, serbe dhe pastaj greke dhe bullgare, filluan qërimin e hesapeve me popullatën shqiptare, e cila bashkë me armatën osmane bënte përpjekje të mbronte trojet e veta nga pushtuesit e rinj, të cilët, nuk kishin për qëllim “çlirimin” nga pushtuesit osmanë, siç thuhej, por pushtimin e etnisë shqiptare dhe rrënimin e qenies së saj deri në themel. Edhe pse vendet ballkanike, pjesëmarrëse të kësaj lufte, bënë përpjekje që të pengohen njoftimet nga vijat e fronteve, burime të ndryshme europiane, ia dolën të nxjerrin në pah përmasat e tmerrshme të golgotës nëpër të cilën po kalonte popullata shqiptare sapo u përball me depërtimeve e ushtrive ballkanike në viset e tyre.<sup>1680</sup>

Po këto burime bëjnë të ditur se gjatë luftës së dimrit të vitit 1912/13 popullata shqiptare e Kosovës dhe ajo në Maqedoninë Perëndimore iu ekspozua një gjenocidi. Nga veprimet ushtarake të ushtrisë serbe dhe asaj malaziasë u vranë mbi tridhjetë mijë veta, kryesisht të rinj, fëmijë e gra, u zunë robër gjashtë mijë vetë, të cilët u dërguan në burgjet serbe, ndërsa mbi njëqind mijë të tjerë u shpërngulën në Turqi ose në Shqipëri dhe vende të tjera përreth.

Ky kalvar vazhdoi edhe gjatë vitit 1913, pasi që Konferenca e Ambasadorëve në Londër mori vendimin që Kosova dhe viset tjera shqiptare në Maqedoni t’i takojnë Serbisë, ndërsa Çamëria Greqisë. Janë të njohura veprimet e ushtrisë

---

<sup>1680</sup> Më gjerësisht shih Leo Freundlich “*Albaniens Golgotha*”, Wien 1913; Novaković, Kosta: “*Nacionalizacija i serbizacija Kosova*”, Vjenë, 1913.

serbe, asaj malaziase dhe greke, që në emër të “luftimit të bandave shqiptare” të vazhdojnë politikën e tyre për ta rrënuar përfundimisht etninë shqiptare në këto pjesë.

Siç u pa edhe më parë, metodat e ndryshme do të shfrytëzohen, që Shqiptarët të detyrohen të lëshojnë trojet e tyre. Me këtë rast ishte terrori shtetëror ai që duhej të përgatiste terrenin për kolonizimin e trojeve shqiptare me popullatë sllave, në mënyrë që brenda një kohe të shkurtër të ndryshohej pasqyra e saj etnike në dëm të asaj shqiptare dhe në dobi të asaj sllave.

Meqë Lufta e Parë Botërore do ta ndalë për pak këtë proces, megjithatë, vitet e njëzeta deri në ato të dyzetat, do të shfrytëzohen për këtë qëllim. Por, këtë herë, mjetet e luftës së hapur, siç ishin ato gjatë Luftërave Ballkanik do t’i zëvendësojë lufta kundër “terroristëve” (ky term përfshinte kaçakët dhe gjithë ata që i takonin Lëvizjes së Rezistencës Kombëtare kundër pushtimit serb), si dhe programi shtetëror për kolonizim, që do të shfrytëzojë reformën agrare dhe mundësitë e saj të shumta që Shqiptarët të privoheshin nga pronat e tyre, me çka atyre nuk u mbetej tjetër pos të kërkonin shpëtim me anën e shpërnguljes në Turqi ose ikjes në Shqipëri.

Në këto rrethana, ishte elita intelektuale serbe e tubuar rreth “Klubit Kulturor Serb”, e cila vazhdonte të ushqejë politikën e Beogradit si dhe aparatit e saj shtetëror me ide hegjemoniste për të jetësuar “Naçertanjen”.

Por, të pakënaqur me rezultatet e kolonizimit, të cilat diku nga mesi i viteve të tridhjeta, sipas tyre, ishin dukshëm nën parashikimet (në Kosovës ishin vendosur rreth 10 mijë familje kolonësh me 60 mijë vetë në vend të 140 mijë sa ishin paraparë), e më të pakënaqur me procesin e shpërnguljes së Shqiptarëve në Turqi dhe Shqipëri (nuk ishin shpërngulur më shumë se 150 mijë, ndërkohë që parashihej që për njëzet vjet ky numër të arrinte dyfishin), elita intelektuale serbe do të shfaqë shqetësime për dështimin e politikës nacionale në Kosovë dhe në pjesët e banuara me shqiptarë në Maqedoni. Sepse, sipas tyre, nuk ia kishte dalë që të ndryshonte pasqyrën etnike në Kosovë dhe të Maqedonisë në dobi të Serbëve, gjë që rrezikonte interesat nacionale serbe. Andaj, rrugëdalja e vetme kërkohej nga shpërngulja në masë e Shqiptarëve në Turqi dhe Shqipëri me arritjen e marrëveshjeve me këto dy vende, sidomos me Turqinë, e cila tashmë kishte arritur marrëveshje të ngjashme me Greqinë, Bullgarinë dhe Rumaninë për pranimin, si thuhej të popullatës turke dhe “riatdhesimin” e saj në Turqi.

Që këto marrëveshje me Turqinë të kishin mbështetje sa më të fuqishme “intelektuale” e me këtë edhe një konsensus të brendshëm shoqëror dhe politik, do të përkujdeset “Klubi Kulturor Serb” i Beogradit. Do të hapet një debat i gjerë

publik rreth kësaj çështje prej nga duhej të nxirrej një platformë nacionale, e cila do të ishte obliguese për shtetin dhe veprimet e tij të mëtutjeshme në këtë drejtim, veçmas kur kjo politikë kishte filluar të mos kishte mbështetje te popujt shtetformues: Sllovenët dhe Kroatët dhe të refuzohej nga e majta jugosllave (socialdemokratët dhe komunistët), e cila, duke u mbështetur në parimet e internacionalizmit proletar dhe konceptet ideologjike të Kominternit, kishte filluar ta kundërshtonte këtë politikë duke e quajtur hegjemoniste dhe shoviniste. Andaj, në këto rrethana, hegjemonizmit serbomadhi duhej një propagandë e fuqishme “mbrojtëse” nga “rreziku shqiptar” si dhe “shumimi i tyre në jug”, që sipas Dr. Borivoje Panjevacit, sekretar i Statistikës së Përgjithshme Shtetërore, “ai rrezik do të jetë gjithnjë e më i madh për elementin serb”.<sup>1681</sup>

Më tutje Panjevac, duke hapur këtë debat në “*Klubin Kulturor Serb*”, alarmon për atë se “te Shqiptarët po zgjohet ndjenja nacionale”. Sipas tij, “ky zgjim ka kushte të përshtatshme, sepse popullata shqiptare është e banuar në vise kompakte dhe në vend që ajo të asimilohet, siç është dëshira e shtetit, në realitet po ngjan e kundërta”. Këtë e ilustron me faktin se “fëmijët e kolonëve, në vend që t’u imponojnë gjuhën serbe fëmijëve të Shqiptarëve, po ngjan e kundërta, pse fëmijët serbë po e mësojnë shqipen, dhe kështu po flasin shqip në vend që ata këtë gjuhë të mos e flasin edhe nëse e dinë. Por rreziku më i madh qëndron në faktin (kur djegiet në masë nuk dhanë sukses), te Shqiptarët gjithnjë e më shumë po vërehen ndjenjat turkofile, si te klerikët që deri më tash janë konsideruar vetëm turq, ashtu edhe me njerëzit e thjeshtë, të cilët edhe në momentet më të vështira gjuhën dhe plisin nuk e harrojnë.”<sup>1682</sup>

Krahas kësaj, për Panjevacin, alarmuese shfaqet shtimi i natalitetit të Shqiptarët, në vend se të jetë e kundërta, me ç’rast ai për herë të parë përmend çështjen e “ekspansionit biologjik” si “armë” të Shqiptarëve, e cila do të gjejë pasqyrim të gjerë te Vasa Çubrilloviqi dhe elaborati i tij “*Shpërngulja e Shqiptarëve*”, për të cilin do të bëhet fjalë në vijim, ku do të dalin në pah tezat më raciste, të ngjashme me ato që nazistët gjermanë, pasi që kishin ardhur në pushtet, tashmë kishin filluar t’i kthenin në programe politike për të vënë në veprim gjenocidin ndaj hebrejve në fund të viteve të tridhjeta dhe në ato të viteve të dyzeta.

Referati i Vasa Çubrilloviqit “*Shpërngulja e Shqiptarëve*” (Iselevanje Arnauta), i mbajtur në “*Klubin Kulturor Serb*” të Beogradit në mars të vitit 1937, me

---

<sup>1681</sup> Hoxha, Hajredin: “*Politika e eliminimit të shqiptarëve nga trualli i Jugosllavisë së vjetër*”, “*Përparimi*”, Prishtinë, nr. 5, 1970, faqe 433.

<sup>1682</sup> Po aty, faqe 433.



ato që konstaton dhe ofron, ndonëse sikur duket “dëshpërues” dhe “kritikues” njëherësh. Ngaqë nuk janë arritur qëllimet nacionale serbe dhe shteti jugosllav nuk i ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë që ka pasur - në të vërtetë Elaborati promovon një politikë shtetërore edhe më hegjemoniste ndaj Shqiptarëve nga ç’ ishte ajo deri atëherë, ku dhuna shtetërore e një spektri të gjerë duhej të kombinohej me metodat diplomatike dhe politike në mënyrë që shpërngulja e Shqiptarëve të arsyetohet jo vetëm si interes strategjik nacional serb dhe jugosllav, por edhe ndërkombëtar. Sepse, mbajtja e “pykës shqiptare”, rrezikon fatin e Ballkanit Qendror, sidomos fatin e komunikacionit të rëndësishëm ballkanik Moravë-Vardar<sup>1683</sup>.

“Problemi i Shqiptarëve në jetën tonë nacionale e shtetërore nuk është i tani-shëm”, thotë Çubrilloviq për të shtuar se “trekëndëshi shqiptar ndau tokat tona të vjetra të Rashës nga Maqedonia dhe Lugina e Vardarit”. Por “pykën shqiptare filloi ta copëtonte Serbia qysh në kryengritjen e parë, duke i dëbuar banorët me veriorë shqiptarë që nga Jahorina” me ç’rast “duke kuptuar e zbatuar konceptet e gjera shtetërore të Jovan Ristiçit, Serbia shkëputi Toplicë e Kostanicë. Në atë kohë krahinat ndërmjet Jastrebcit dhe Moravës Jugore qenë spastruar plotësisht nga Shqiptarët”.<sup>1684</sup>

Natyrisht se për Çubrilloviqin, i cili pranon atë që Serbia që nga Obrenoviçet dhe të tjerët kishte bërë kundër Shqiptarëve dhe etnisë së tyre ishte munduar ta fshehte, duke deklaruar se po “rikthehej në tokat serbe” të pushtuara “nga Osmanët”. Njëherësh kritikon shtetin jugosllav, pse nuk kishte vazhduar me të njëjtin intensitet siç kishte vepruar edhe gjatë luftërave të viteve 1876-1878. Duke thënë se “pjesën tjetër të trekëndëshit shqiptar e kishte për detyrë ta shpartallojë shteti ynë i sotëm nga 1918 e këtej”, Çubrilloviq nuk kritikon gjithaq metodat e deriatëhershme të kolonizimit, të cilat nuk kishin qenë në gjendje të bënin më shumë, por kërkon një sjellje të re, atë të shpërnguljes së tyre në masë, që duhet të bëhet me forcë brutale të një shteti të organizuar. “Shqiptarët është e pamundur të zbrapsen vetëm me anën e kolonizimit gradual”, sepse “ky është i vetmi popull që arriti gjatë njëmijëvjeçarit të fundit jo vetëm të mbrohet, por edhe të zgjerohet”.<sup>1685</sup>

Andaj, duke parë këto zhvillime, që për Çubrilloviqin janë alarmuese, meqë “nëse nuk do t’i qërojmë hesapet me ta ose ia lëmë kohës, për 20-30 vjet do të

---

<sup>1683</sup> Më gjerësisht shih: Čubrilović, Vasa: „Isejlanje Arnauta“, Beograd, 1937, „Delo“, Lubljana, 1986.

<sup>1684</sup> Po aty.

<sup>1685</sup> Po aty.

kemi një irredentizëm të tmerrshëm, gjurmët e të cilit tashmë po duken dhe në mënyrë të pashmangshme do t'i vënë në pikëpyetje të gjitha zotërimet tona në jug”.<sup>1686</sup>

Meqë, kolonizimi ka dështuar, Çubrilloviqi kërkon metodën e shpërnguljes së Shqiptarëve në masë.

“Turqia është dakord, që fillimisht të pranojë 200 mijë të shpërngulur tanë, duke i cilësuar këta Shqiptarë, e kjo është forma më e pranueshme për ne. Dëshirën e Turqisë duhet ta pranojmë me të dyja duart dhe ta shfrytëzojmë sa më parë Konventën për shpërngulje”.<sup>1687</sup>

I vetëdijshëm se kjo mund të ngjallë sadopak shqetësim ndërkombëtar, Çubrilloviqi thotë se “nga kjo anë nuk duhet të shqetësohemi; shpërngulja e disa qindra mijëra Shqiptarëve nuk do të çojë në shpërthimin e një lufte botërore”. Përkundrazi, për autorin e elaboratit, “rreziku më i madh qëndron në atë, që mund të përzihen në këtë çështje aleatët tanë të mëdhenj, Franca dhe Anglia”. Por, si për çështjet e tjera që ka përgjigje, edhe për këtë ai thotë se “atyre u duhet përgjigjur me gjakftohtësi e vendosmëri, sepse është në interesin e tyre sigurimi i linjës Moravë-Vardar, gjë që u pa edhe gjatë luftës së madhe të fundit dhe kjo do të jetë më e sigurt për ne dhe për ata vetëm atëherë kur ne do t'i sundojmë plotësisht këto vise rreth malit të Sharit dhe në Kosovë”.<sup>1688</sup>

Por, sipas Çubrilloviqit dhe bashkëmendimtarëve të tij të shumtë nga radhët e elitës politike dhe intelektuale serbe, për të pasur sukses projekti i shpërnguljes në masë të Shqiptarëve, me rëndësi janë edhe rrethanat që duhet krijuar për këtë proces që ai të vihet në binarë të suksesshëm. Andaj, që të arrihet shpërngulja në masë, sipas Çubrilloviqit, është i rëndësishëm krijimi i një psikoze të përshtatshme, e cila mund të krijohet në shumë mënyra, dhe si parakusht ai thekson bërjen për vete të klerit të tyre dhe të njerëzve me ndikim, si thotë “me para ose me shtrëngim”, ku do të gjenden “sa më shumë agjitorë të cilët do të propagandojnë për shpërnguljen”, e ku thekson se “shtypi ynë mund të bëjë shërbime kolo-sale”.

Në këtë propagandë, duhet të hyjë të lavdëruarit e vazhdueshëm të Turqisë dhe jetën e lumtur atje, ku vend i rëndësishëm duhet të zërë çështja fetare dhe lidhja e Shqiptarëve për të.<sup>1689</sup>

---

<sup>1686</sup> Po aty.

<sup>1687</sup> Po aty.

<sup>1688</sup> Po aty.

<sup>1689</sup> Po aty.

Krahas këtij parakushti, për Çubrilloviqin, megjithatë, mbetet me rëndësi shteti dhe aparati i tij, i cili “duhet ta bëjë sa më të padurueshëm qëndrimin e Shqiptarëve të ne”. Ndër këto detyra, ai thekson: gjobat, burgimet, zbatimin në mënyrë të pamëshirshme të të gjitha dispozitave policore, ku do të detyrohen sa më shumë njerëz të punojnë angari dhe të merret çdo masë tjetër që mund të zbatohet një polici me përvojë. Këtyre masave duhet t’u shtohen edhe ato juridike dhe ekonomike: mosnjohja e tapive, vënia e taksave pa mëshirë, detyrimi i shlyerjes së të gjitha borxheve private e publike, marrja e kullotave shtetërore dhe komunale, zhveshja nga koncesionet, heqja e lejeve afariste, pushimi nga puna shtetërore, private, vetadministruese e të tjera.<sup>1690</sup>

Me rëndësi që t’u nxihet jeta Shqiptarëve që ata të shpërnguleshin sa më shpejt dhe në numër sa më të madh ishin edhe “masat sanitare”, ku përfshiheshin disa masa të padurueshme nëpër shtëpi si rrëzimi i mureve dhe rrethojave të shtëpive, gjë që prekte në moralin e brendshëm të familjes, pastaj përdorimi i rreptë i masave të veterinarisë, me të cilat Shqiptarëve do t’u pamundësohej nxjerrja e bagëtive në treg dhe masa të tjera, ndër të cilat parashiheshin edhe ato të prishjes së varreve, ndalimit të martesave si dhe të fyerjeve dhe nënçmimeve të tjera që duhej t’i takonin në jetën e përditshme.<sup>1691</sup>

Një aspekt tjetër i dhunës shtetërore, duhet të pasqyrohej edhe me shpër-ndarjen e armëve kolonëve, në mënyrë që në këto vise prapë të organizohet aksioni i vjetër çetnik. Për këtë qëllim, Çubrilloviq kërkon provokimin e përhershëm të popullatës shqiptare me anën e kolonëve malazias, të cilët duhet të sillen aty që të krijojnë konflikte të hapura me Shqiptarët në Dukagjin, që të krijohet një psikozë sikur Shqiptarët kanë ngritur krye, në mënyrë që pastaj, të përdoret dhuna shtetërore për ta shuar. Çubrilloviqi kërkon që shteti me njerëzit e vet të nxitë edhe turbullira lokale, të cilat do të shtypen në mënyrë të përgjakshme me mjete më efikase, por jo aq me ushtri sa me kolonë, me fise malaziasë dhe me çetnikë.<sup>1692</sup>

Dhe si masë e fundit, me të cilën duhet arritur qëllimin, sipas Çubrilloviqit, “mbetet edhe një mjet, të cilin Serbia e ka përdorur në mënyrë shumë praktike pas vitit 1878, duke djegur ilegalisht fshatra dhe blloqe qytetesh shqiptare”.<sup>1693</sup>

Çështje me rëndësi, për Çubrilloviqin, paraqitet edhe organizimi i shpërnguljes së Shqiptarëve, në mënyrë që me anën e saj të realizohen qëllimet strategjike.

---

<sup>1690</sup> Po aty.

<sup>1691</sup> Po aty.

<sup>1692</sup> Po aty.

<sup>1693</sup> Po aty.

Andaj ai propozon edhe rrethet që duhet të shpërngulen, si dhe ecurinë që duhet ndjekur, në radhë të parë të kihet parasysh shpërngulja e fshatrave dhe mandej e qyteteve. “Fshatrat janë më kompakte, prandaj paraqesin rrezik.” Ai thotë se “nuk duhet shpërngulur vetëm të varfrit, por edhe njerëzit e mesëm e të pasur. Vetëm në këtë mënyrë mund të krijohet lumi i Shqiptarëve të shpërngulur i cili do të zbrazë Jugun tonë nga Shqiptarët”. Sepse, “duke mos kursyer as gjak e as para, shteti ynë do të mund të krijonte nga Kosova dhe Metohija një Toplicë të re”.<sup>1694</sup>

Përmendja e krijimit të një “Toplice të re” nga Kosova dhe Metohija, ka të bëjë me përsëritjen e modelit të pastrimit etnik masiv me anën e “blic-krigut”, siç ishte Lufta Serbo-Osmane e vitit 1876/7 dhe ajo e shfrytëzimit të luftës ruse-osmane të vitit 1878, kur Serbia do të rikthehet ushtarakisht në Toplicë dhe do të bëjë pastrimin e fundit etnik të popullatës së atjeshme shqiptare, duke ia shuar që të gjitha gjurmët një entiteti. Si do të shihet, këtë skenar, Çubrilloviq, do ta përmend disa vite më vonë, në prag të mbarimit të Luftës së Dytë Botërore kur do të dalë me një elaborat tjetër, atë “*Problemi i pakicave në Jugosllavinë e re*”.Elaboratin e dytë, ai do t’ia paraqesë në nëntor të vitit 1944 udhëheqjes më të lartë të Lëvizjes Antifashiste Nacional-Çlirimtare të Jugosllavisë (LANÇJ) për të zgjidhur çështjen e pakicës hungareze dhe asaj shqiptare me pretekstet se ata ishin bashkëpunëtorë të fashizmit.

Krahas elaboratit të Çubrilloviqit rreth “Shpërnguljes së Shqiptarëve”, si një referencë e rëndësishme të Konventës jugosllave-turke për shpërnguljen e Shqiptarëve në Turqi, në “Klubin Kulturor Serb” vazhduan të shfaqen pikëpamje të ndryshme mbi këtë temë, emërues i përbashkët i të cilave mbetej shteti jugosllav, i cili duhej të vepronte me të gjitha mjetet në drejtim të shpërnguljes së Shqiptarëve për në Turqi e mundësisht edhe në Shqipëri. Ndër shumë pikëpamje të tilla, kishte edhe aso, që krahas shpërnguljes jashtë, parashihnin edhe atë të zhvendosjes së Shqiptarëve nga etnia e tyre në pjesë të tjera të vendit, konkretisht në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në Kroaci. Gjoka Perina, një titullar i Lidhjes së Kooperativave Serbe në Sarajevë, propozon shpërnguljen ciklike brenda shtetit. Sipas tij, ndërrimi i këtyllë i popullsisë shqiptare nuk kërkon mjete të mëdha, ndërsa ata do të humbin në detin e gjerë sllav.<sup>1695</sup>

Hapja e çështjes shqiptare në “Klubin Kulturor Serb” dhe “zgjidhja” e saj me anën e shpërnguljes masive që duhej ta merrte përsipër shteti, i cili para-

---

<sup>1694</sup> Po aty.

<sup>1695</sup> Hoxha, Hajredin: “Politika e eliminimit të shqiptarëve nga trualli i Jugosllavisë së vjetër”, në “Përparimi”, nr.5, 1970, faqe 434.

prakisht duhej të krijonte rrethanat e brendshme që ky proces të vihej në veprim me anën e terrorit shtetëror, pa përjashtuar këtu edhe mjetet më ekstreme siç ishte ndezja e konflikteve dhe turbullirave që duhej t'u jepej dimensionit i "kryengritjeve separatiste", në këtë mënyrë që në emër të të drejtës së mbrojtjes së shtetit, të justifikohet edhe përdorimi i mjeteve të luftës, flet për gjendjen e rëndë në të cilën ndodheshin Shqiptarët gjatë okupimit serbo-jugosllav, të shkaktuar nga politika hegjemoniste serbomadhe e këtij vendi. Ajo tashmë jo vetëm që nuk i fshihte qëllimet e saj për zhdukjen e tyre me dhunë, por kërkonte që ato, si programe shtetërore, të ktheheshin në prioritet të politikës shtetërore, në mënyrë që siç thoshte Çubrilloviqi në elaboratin e tij të merrnin epilogun e duhur ngaqë mund të ishte një luftë e ardhshme botërore, ose një revolucion socialist, që në një të ardhme të afërme ishin të mundur, që ato t'i pengonte.

Si do të shihet, do të jetë Lufta e Dytë Botërore, që këtë proces do ta ndalë për pak.

Natyrisht, se në këtë zhvillim, krahas faktorëve të jashtëm, që kishin luajtur një rol mbase edhe vendimtar, do të jetë edhe përkushtimi i vetë Shqiptarëve, që t'u rezistojnë programeve hegjemoniste serbe me të gjitha mjetet (nga rezistenca e armatosur e deri te përfshirja e mundimshme në jetën politike të vendit). Këtë do ta pranojë edhe vetë Çubrilloviqi kur do të pohojë në njërin anë "nacionalizmin shqiptar i cili edhe në viset tona po rritet" dhe në tjetrën anë , "pjelloria e grave shqiptare e cila kishte mundur politikën e kolonizimit tonë".

## "XHEMJETI" I SHKUPIT DHE PËRPJEKJET PËR ASIMILIMIN E SHQIPTARËVE NËPËRMES ISLAMIZIMIT

Krahas rezistencës së armatosur ndaj pushtimeve serbe, siç ishin ato gjatë viteve 1912-1913 si dhe atyre të mëvonshme, që u pasqyruan me lëvizjen kaçake dhe forma të tjera të rezistencës popullore, të cilat e ngadalësuan në masë të madhe procesin e kolonizimit të Kosovës dhe të viseve shqiptare në Maqedoni për ta sjellë buzë dështimit, do të jetë edhe përfshirja e Shqiptarëve në jetën politike të vendit, si një formë tjetër që do t'i bëhet rezistencë shpërnguljes së tyre për në Turqi dhe vendet e tjera në përputhje me programet hegjemoniste serbomëdha, të cilat Beogradi ia kishte imponuar shtetit jugosllav.

Ndonëse përfshirja e Shqiptarëve në jetën politike të vendit ishte e veçantë, sepse ajo, në njërin anë, zhvillohej në kushte të jashtëzakonshme nëpër të cilat

kalonin Shqiptarët kur ndaj tyre zhvillohej një terror shtetëror i sofistikuar që ata të shpërnguleshin sa më shumë dhe sa më parë dhe në tjetrën anë, nga aspekti politik, atë e kthente në një farsë tragjike ndër më të pashembulltat e kohës, megjithatë ajo, përkundër të gjitha të metave dhe dobësive dhe përkundër manipulimeve të pashmangshme nëpër të cilat kaloi, duhet parë si pjesë e rezistencës së gjithmëmbarshme ndaj shpërnguljes në Turqi. Pa këtë segment, sigurisht se shpërngulja e Shqiptarëve në Turqi dhe vendet e tjera, jo vetëm që do të arrinte maksimumin, por do t’iu ndihmonte edhe shthurjes së etnisë shqiptare në këto hapësira, mbetjet e së cilës do t’i bashkoheshin ndonjë sajese “myslimane” apo të ngjashme që pastaj do të paraqitej si “substrat sllav i islamizuar”, të cilit “po i krijoheshin mundësitë që të shpreh identitetin e rrënjës”!

Por, edhe përkundër këtyre kushteve të veçanta nëpër të cilat kalohej, përfshirja e Shqiptarëve në jetën politike të vendit, praktikisht do të fillojë pas vitit 1920, kur Mbretëria Serbe-Kroate-Sllovene kishte shpallur parlamentarizmin, të cilit, së paku formalisht, duhej t’i nënshtroheshin edhe Shqiptarët, ndonëse atyre nuk u pranohej identiteti kombëtar, por vetëm ai fetar (si myslimanë, gjë që mbi këtë premisë ata mund të deklaroheshin turq). Madje, mund të thuhet, se për njëfarë pjesëmarrje simbolike të Shqiptarëve (natyrisht si popullatë e besimit mysliman), ishte e interesuar edhe Mbretëria SKS, përkundër politikës së saj të njohur hegjemoniste dhe shoviniste ndaj tyre që ia impononin Serbët si popull shtetformues, që kishte fjalën kryesore në dinastinë e Karagjorgjeviqëve. Sepse, me anën e parlamentarizmit, para botës krijonin përshtypjen si vend ku të gjithë qytetarët, pa dallim, janë të barabartë në jetën politike dhe ekonomike. Ndërkohë që në planin e brendshëm, duke veçuar një grup feudalësh nga shtresat e gjera popullore dhe duke i kthyer në lodra të partive nacionaliste serbe me të cilat ato fitonin vota, humbej besimi në çfarëdo ardhmërie, gjë që mund të nxiste edhe më shumë shpërnguljen për në Turqi ose gjetiu.

Sidoqoftë, Shqiptarët, qoftë edhe të trajtuar zyrtarisht “turq”, “myslimanë” ose ndryshe, për aq sa ishin në Kosovë, Maqedoni dhe trojet e tyre të përfshira në Mbretërinë SKS, shfaqeshin si elektorat, gjë që ata i kthente në “kapital” të partive politike, me të cilin mund të fitohej një numër i mirë i deputetëve (deri në 20, numër ky që ishte i barabartë me afër 9% të numrit të përgjithshëm të vendeve në parlament), që për t’u marrë duhej të lidheshin me ndonjë kundërvlerë, pa marrë parasysh çfarë ishte ajo. Kështu, nga vitit 1919, krahas Partisë Radikale të Nikolla Pashiqit, e cila kishte vazhduar veprimtarinë e vet të filluar në kohën e Mbretërisë Serbe, në hapësirën e Kosovës dhe të Maqedonisë Perëndimore (filli-

misht të përfshira nëpër qarqe, ku ai i Shkupit ishte më i madhi e më vonë në banovina: atë të Zetës, të Moravës dhe të Vardarit), do të shfaqet edhe Partia Demokratike e Svetozar Pribiçevićit, e cila ishte themeluar në Sarajevë dhe në programin e saj anonte nga konceptet borgjeze të Europës Perëndimore. Aty ishin edhe partitë e majta socialiste, të cilat shfaqeshin me programe ideologjike, socialdemokratët dhe komunistët me parullat rreth barazia klasore, ndërkohë që i bëhej kritikë e ashpër politikës hegjemoniste serbomadhe dhe dinastisë mbretërore, parti këto që si do të shihet, me “Obznanën” shpejt do të ndalohen, kështu që ato do të kalojnë në ilegalitet.

Në këto rrethana mbeteshin Radikalët dhe Demokratët pretendentët kryesorë për elektoratin e Kosovës dhe atë në Maqedoni. Partia Demokratike, ndonëse me pikëpamje nacionaliste serbe, së paku deklarativisht, u përpoq që në programin e saj të afirmojë idenë e shtetit të përbashkët jugosllav në baza centraliste. Kjo parti, e cila ndjehej si “shtetformuese”, u mundua të harmonizojë unitarizmin nacional me interesat shtetërore, por në masë të madhe duke favorizuar borgjezinë serbe.<sup>1696</sup>

Shikuar nga kjo pikëpamje Partia Demokratike, dukej më larg nga elektorati shqiptar i Kosovës dhe ai i Maqedonisë, nga Partia Radikale e Pashiqit, ngaqë kjo e dyta, përkundër programit të saj nationalist, qysh në Konferencën e Vendit që do ta mbajë në shtator të vitit 1920, nxori disa përfundime të reja për programin e vet, duke ia adaptuar rrethanave të reja. Me këtë rast Radikalët u shprehën se angazhoheshin për parimin e vetëqeverisjes në krahina, komunë, rrethe dhe qark, deri në atë masë sa që mos të vihet në sprovë bashkësia shtetërore. Kjo parti, po ashtu, parashihte ruajtjen e pronës private, mbrojtjen e kapitalit privat si dhe stimulonte kapitalizmin, gjë që shfaqej joshës për shtresën feudale, e cila ishte e interesuar që të ruante pronat, por edhe kapitalin.

Madje, kjo parti, në aktivitetet nismëtare nëpër Kosovë dhe Maqedoni, u bëri thirrje Shqiptarëve që t’i bashkohen asaj, duke premtuar se do të jenë të barabartë në arsim, kulturë, ekonomi dhe në të gjitha fushat e tjera, pa përjashtuar këtu edhe vetëqeverisjen krahinore dhe atë nëpër komuna, ku interesat vendore do të jenë parësore.<sup>1697</sup>

Këto dhe premtimet e ngjashme bënë që disa nga krerët vendorë shqiptarë të tregonin interesim për këtë parti, me të cilën filluan të bashkëpunojnë. Kësaj do

---

<sup>1696</sup> Më gjerësisht rreth Partisë Demokratike shih Gavrilović, Branislav: „*Demokratska stran-ka*“, Beograd, 1970.

<sup>1697</sup> Më gjerësisht rreth Partisë Radikale shih Mitrović, Živan: “*Srpske političke stranke*“, Beograd, 1939.

t'i ndihmojë edhe fakti se, lideri i kësaj partie, Pashiqi ishte në pushtet dhe mbante penjtë e politikës së vendit, duke bërë që atë ta kthente në një parti shteti.

Por, për forcat e caktuara politike shqiptare, nga radhët e feudalëve të paktë ose të klerit islam, përkundër rrethanave të vështira nëpër të cilat kalonte popullata shqiptare, e cila ishte ballafaquar me diskriminim të hapur, pa përjashtuar këtu edhe dhunën dhe terrorin shtetëror që kryhej ndaj saj në emër të zbatimit të “Ligjit për mbrojtjen e shtetit” të shpallur dhe të dekretëve të tjera “kundër terrorizmit”, në Shkup u themelua partia e parë politike me emrin “*Shoqata Islame muhavazihukug*”, ose “*Xhemjeti*”, që ndër Shqiptarët u quajt edhe “*Bashkimi*”.

Kuvendi i saj themelues u mbajt më 18 dhjetor 1919. Në kuvendin themelues morën pjesë 64 pjesëmarrës. Kryetar u zgjodh Nexhip Draga, luftëtar i denjë i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare (deputet në Parlamentin Osman), nënkryetar Sheh Sadedini, ndërsa sekretar Aqif Blyta. Politika zyrtare e Mbretërisë SKS kuvendin e vlerësoi “*Kongres i Myslimanëve të Jugut*”, të përbërë nga “Turq, Sllavë të islamizuar dhe Arnautë”.<sup>1698</sup>

Në të vërtetë “Xhemjeti” kishte petkun fetar (islam), orientimin turk (gazeta e saj “Hak” do të botohet në gjuhën turke dhe atë serbe), ndërsa dihej se përfaqësonte dhe mbronte interesat e Shqiptarëve.

Ky maskim ishte i domosdoshëm, sepse Mbretëria SKS nuk njihte kombësinë shqiptare, ndërsa lejonte atë turke, pranonte “identitetin islam”, të cilit i lejohej pasqyrimi në planin shoqëror, kulturor, por edhe politik me të cilin duhej të eliminohej, por edhe të luftohej deri në pikë të fundit identiteti shqiptar qoftë edhe si i papranuar.

Natyrisht se brenda këtij konstrukti dhe në këto rrethana, ku “dekori i lirisë së shprehjes fetare” përjashtonte identitetin kombëtar (shqiptar), mbrojtja e interesit të Shqiptarëve, së paku në planin shoqëror dhe ekonomik, ku mbrojtja nga diskriminimi si dhe shpërngulja e organizuar, shfaqej si prioritet kryesor.

Kjo parti, megjithatë, nuk ishte në gjendje që të ruante autonominë e vetë, meqë ajo ndodhej në gërshtimin e ashpër të dy partive rivale serbe në këtë pjesë: asaj Radikale dhe Demokrate, të cilat ishin të interesuara për elektoratin e banovinave ku përfshiheshin shqiptarët (Zetës, Moravës dhe sidomos të Vardarit me kryeqendër Shkupin), por që këtë ta bëjnë disi, duke ruajtur edhe “Xhemjetin”, jo si partner koalicioni, po si një vasal, të cilit i caktoheshin detyrat dhe i jepej

---

<sup>1698</sup> Shih: “*Arhiv Vojnog Insitutat Istorije Jugosllavije*” (AVII), P. IV/3, Kutia 54, dok. 228/2.



ndonjë shpërblim për këtë. Por, edhe si e tillë, “Xhemjetit”, zuri t’i ngushtoj hapësira, veçmas pas prononcimeve kundër shpërnguljes së Shqiptarëve dhe kërkesës për kthimin e muhaxhirëve shqiptarë, të bërë nga deputeti Ferhat Ali Draga në Parlamentin Jugosllav, të cilën ai e deponoi edhe në Konferencën e Hagës.<sup>1699</sup>

Kjo deklaratë shtyri Beogradin që të punojë për ta rrënuar nga brenda këtë parti me anën e krijimit të fraksioneve të ndryshme, por edhe me trysni të tjera nga jashtë, që do të çojnë te shkatërrimi i saj katër vjet më vonë, madje edhe te burgosja e Ferhat Ali Dragës.<sup>1700</sup>

Si rrjedhojë e këtyre presioneve, kur do të dalin në pah dy-tri fraksione, që do të kërkojnë që partia t’i kthehet çështjes fetare, në Kongresin e Dytë më 1921, partia ndërroi emrin në “*Organizata Myslimane e Serbisë Jugore e Mbretërisë SKS*”, gjë që tregonte qartë se Beogradi nuk dëshironte kurrfarë organizimi politik të Shqiptarëve, pos atij fetar, i cili ishte i domosdoshëm që atyre, në njërin, t’u çrrënjosej çfarëdo vetëdije kombëtare dhe në tjetrën anë, t’u forcohej ajo fetare dhe e të qenit “turq”. Me anën e saj mund të shpërnguleshin lirisht, çështje kjo që për një pjesë të popullatës që nuk mund t’i bënte ballë diskriminimit dhe dhunës së përhershme shtetërore që ushtrohej ndaj saj, ose që nuk mund t’u përshtateshin rrethanave të reja, të fitonin mundësinë për t’u larguar nga vendi.

Në përputhje me këtë orientim që iu imponua nga shteti, struktura organizative e kësaj partie, rumbullakohet në Kongresin e Tretë, më 4 prill 1922, me ç’rast ajo tashmë kishte karakterin e një shoqate të gjerë, në të cilën përfshiheshin që të gjitha rrymat politike në të cilat ishin të përfshirë Shqiptarët pa pasur të drejtë që politikisht të identifikohen si të tillë. Kështu, në këtë kongres morën pjesë 11 deputetët shqiptarë që ishin zgjedhur në parlamentin jugosllav. Kongresi zgjodhi kryetar Qenan Zijanë nga Manastiri, nënkryetar Ismet Bej Kemalin, deputet nga Gjakova dhe arkëtar Kemal Osmanin nga Shkupi. Nga viset e Kosovës, përfaqësues në kongres ishin: nga Prishtina Haxhi Xhemajl Efendija dhe Sylejman Haxhi Efendija, nga Gjilani Hysein Agë Okllani dhe Sherif Bajrami, nga Peja Nazif Bej, nga Pazari Aqif Haxhi Ahmeti. Në Kongres mori pjesë edhe Sali Jusufi si përfaqësues i Llapit. Në Kongres u vendos që “*Hak*” të dalë çdo ditë në gjuhën turke, kurse dy herë në javë në gjuhën serbe. Gazeta duhej të redaktohej dhe të botohej në Beograd.<sup>1701</sup>

---

<sup>1699</sup> Shih: Osmani, Jusuf: “*Kolonizimi, reforma agrare dhe shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova 1918-1941*”, II, 2016, faqe 93-96, 88-111.

<sup>1700</sup> Shih: gazeta “*Pravda*”, 18.I.1925.

<sup>1701</sup> Shih: “*Iz Istorije Jugoslavije*”, Beograd, 1958, faqe 199.

Ky përcaktim kishte rëndësi për pushtetin jugosllav, që me anën e një gazete të tillë, te Shqiptarët të imponohej vetëdija turke bashkë me atë serbe, pikërisht siç do ta thotë edhe Çubrilloviqi “Shqiptarëve t’u krijohet bindja se i takojnë Lindjes dhe vetëdijes islame”.<sup>1702</sup>

Para se të ndodhin këto zhvillime, Kosova dhe Maqedonia, të shpërndara tashmë administrativisht në disa qarqe të lidhura me rrethe në Serbi (të Zetës, Moravës dhe Vardarit), do të futen në zgjedhjet e para parlamentare: në ato komunale në gusht të vitit 1920 dhe ato parlamentare të 28 nëntorit 1920, të cilat njëherësh duhej të shfrytëzoheshin për demonstrimin e politikës hegjemoniste të Beogradit në këto anë, e cila duhej të shkonte në dobi të krijimit të mëtutjeshëm të psikozyës për shpërnguljen e Shqiptarëve.

Në këto rrethana, në rrethet e Graçanicës, të Zveçanit, të Shkupit dhe të Manastirit, në të cilat ishin të përfshira të gjitha vendbanimet e deridjeshme të Kosovës dhe të Maqedonisë Perëndimore, në zgjedhjet parlamentare u paraqitën katër parti: Partia Radikale, Partia Demokratike, Partia Komuniste dhe “Xhemjeti”. Kjo e fundit ishte në koalicion me Partinë Radikale, dhe ia doli të fitojë tre deputetë, njëri prej tyre Shqiptar (Mehmet Ali Mahmuti). Këto katër parti fituan 18 deputetë, prej tyre 10 Serbë dhe 8 Shqiptarë. Vlen të theksohet se në Kosovë ishin 85.159 zgjedhës të regjistruar, ndërsa në zgjedhje dolën 46.561 vetë. Më së shumti deputetë fitoi Partia Demokratike 9 sish (katër Shqiptarë: Sherif Bajrami, Ramush Osmani, Sefedin Mahmutbegu dhe Ismet Karabegu), Partia Radikale fitoi tre deputetë (një shqiptar: Musa Sheh Zade), Partia Komuniste fitoi tre deputetë (një Shqiptar: Ethem Bylbyli i Zveçanit).<sup>1703</sup>

Zgjedhjet parlamentare të vitit 1920, edhe pse do të duhej të mbeteshin në kuadër të një kornize të garës zgjedhore, megjithatë, gjatë dhe pas mbajtjes së tyre, u kthyen në një manifestim të hegjemonizmit serbomadhi, ku u demonstrua fryma antishqiptare. Kjo atmosferë doli në pah, veçmas pas shpalljes së rezultateve përfundimtare. Radikalët e Pashiqit, të dëshpëruar që nuk kishin marrë më shumë se tre deputetë (kishin llogaritur se do të merrnin 12-13), do t’u kthehen metodave të njohura të qërimit të hesapeve me Shqiptarët. Këtë herë, në shkurt 1921, pasi që do të kenë demonstruar në Prishtinë dhe rrugët e tjera të qyteteve të Kosovës, duke u kërcënuar me gjakderdhje, policia e Beogradit që drejtohej nga Radikalët, me pretekst të pastrimit të vendit nga kaçakët, që ato ditë kishin vrarë një xhandar (ndonëse kjo nga popullata shqiptare nuk konfirmohej dhe thuhej se as

<sup>1702</sup> Shih Çubrilloviq, Vasa: “*Shpërngulja e Arnautëve*” (dokument) te Verli, Marenglen, vep. Cit., faqe 183-185.

<sup>1703</sup> Shih: “*Arhiv Jugoslavie*” (Arkivi i Jugosllavisë), sinjatura 14, fascikli 15/18, dosje 1129 dhe 27625.

që kishte pasur “luftë” me kaçakët siç alarmohej në të katër anët), hyri në Llap dhe bëri një gjenocid të vërtetë, duke vrarë e masakruar qindra Shqiptarë. Ngjashëm u veprua edhe në disa qytete e katunde shqiptare, ku aksionet e xhandarmerisë të shoqëruara nga çetnikë vendorë të mbledhur rreth shoqatës “patriotike” “Bela ruka”, themeluar nga Radikalët “për mbrojtje nga terroristët”, arsyetohehin me “terrorin” e kaçakëve.<sup>1704</sup>

Legjislatura e parë e cila u mbledh më 8 dhjetor 1920, solli ndryshimet e para, të cilat shkuan në dëm të demokracisë dhe në dobi të forcimit të unitarizmit, të cilin e drejtonin partitë serbe (Radikale dhe Demokrate). Këto parti imponuan kushtetutën e re, me të cilën u nxor edhe ligji “Për mbrojtjen e shtetit”, me të cilin u përjashtuan nga demokracia lëvizja punëtore dhe e majta. Me këtë ligj, po ashtu, pakicave iu ndaluan partitë politike, siç u krijua edhe një platformë diskriminuese për pjesëmarrjen e tyre politike në partitë e “popujve shtetformues”. Ndër to ishte nënshkrimi i deklaratës së lojalitetit shtetëror, deklarimi i gatishmërisë së përfshirjes në luftë “kundër terrorizmit” dhe njohja e gjuhës serbe dhe e shkrim leximit. Kjo e fundit përjashtonte një pjesë të madhe të popullatës shqiptare nga çdo aktivitet politik të kësaj natyre si dhe të drejtën për t’u zgjedhur, meqë në gishta numëroheshin ata që mund ta plotësonin këtë kusht.

Në këto rrethana, në Kosovë dhe Maqedoni filloi dhuna e Radikalëve, të cilët, si parti në pushtet, në përbërje të së cilës ishin edhe deputetet e “Xhemjetit”, ndërmori një fushatë të gjerë të demonstrimit të fuqisë si parti shtetërore, e cila kërkonte që Shqiptarëve t’u imponohej dhunshëm pa u lënë alternativë. Në përputhje me këtë përcaktim, Radikalët themeluan degët e partisë në të gjitha qytetet e Kosovës dhe të Maqedonisë, duke përfshirë dhunshëm në udhëheqjen e saj njerëzit me ndikim, por edhe të tjerët, të cilët detyroheshin të deklaroheshin se “me vullnet” i bashkoheshin kësaj partie. Falanga e saj “Bela Ruka” (njësi paramilitare çetnike e lidhur me oborrin mbretëror), sillte qytetarët nëpër tubimet e kësaj partie dhe i detyronte që të anëtarësoheshin. Madje, në këshillat vendorë të radikalëve, Shqiptarët detyroheshin që të mbanin fjalime përshëndetëse në dobi të kësaj partie.<sup>1705</sup>

Kjo bëri që në zgjedhjet e vitit 1923 “Xhemjeti” të futet në koalicion me Radikalët, “lidhje” kjo që ishte fare e panatyrshme dhe e dëmshme për të, por ajo ishte e imponuar dhe e paraparë që ashtu edhe të shkatërrohej. Kjo ndodhi pas dy

---

<sup>1704</sup> Rreth masakrave që u bënë në Kosovë gjatë muajve shkurt-prill 1921 shih gazetën “Pravda”, shkurt 1921, “Hak”, shkurt 1921 dhe “Samoupravna”, 3 shkurt 1921.

<sup>1705</sup> Më gjerësisht shih gazeta “Samoupravna” shkurt-mars 1922.

vitesh, kur Radikalët nuk do të jenë në gjendje që t'i mbikëqyrin të gjitha veprimet e liderëve të tij, veçmas të autoriteteve, siç ishte Ferhat Ali Draga, i cili do të përpiqet që hapësirën parlamentare ta shfrytëzojë për të nxjerrë në pah gjendjen e rëndë të Shqiptarëve si dhe dhunën shtetërore ndaj tyre.<sup>1706</sup>

Të njohura do të jenë qëndrimet e tij kundër shpërnguljes së Shqiptarëve në Turqi dhe reformën agrare, e cila ishte vënë në shërbim të kolonizimit të Kosovës me Serbë dhe në dëm të Shqiptarëve, por po ashtu, të njohura janë edhe deklaratat dhe protestat me rastin e dhunës së organizuar që ushtrohej ndaj Shqiptarëve nga militantët e radikalëve dhe të demokratëve si dhe të “Dorës së Bardhë”, e cila organizonte fushata “patriotike” kundër “terroristëve”, me ç’rast për militantët e saj “terroristë” ishin gjithë ata Shqiptarë që nuk pajtoheshin me politikën shtypëse të Beogradit dhe kundërshtonin shpërnguljen në Turqi. Edhe pse ishte në koalicion me Radikalët, Ferhat Draga, i cili nga Demokratët dhe të tjerët cilësohej “vegël e radikalëve”, do të fillojë të nxjerrë në pah ujdinë e këtyre dy partive “armike” në vend, rreth terrorit shtetëror në Kosovë, të cilat bashkëpunonin ngushtë në këtë çështje. Si dëshmi për këtë, para parlamentit jugosllav ai solli rastin e zgjedhjeve komunale të gushtit 1923, kur në gjithë Kosovën, veçmas në Prishtinë dhe Mitrovicë, këto parti organizuan terror shtetëror ndaj Shqiptarëve. “Të gjithë ata që përdorën terrorin gjatë zgjedhjeve komunale nuk i konsideroj as radikalë e as demokratë, sepse ata janë gjakpirës, sepse një shtypës gjithmonë është shtypës. Është turp dhe marri që ndër ne të derdhet aq shumë gjak në Prishtinë dhe Mitrovicë, dhe kjo të ndodhë ditën e zgjedhjeve”.<sup>1707</sup>

Me këtë rast Draga shpjegoi edhe arsyet pse ishte përcaktuar për lidhjen me Radikalët, që sipas tij ishte e pashmangshme për t'i arritur disa qëllime. “Ne prej Partisë Radikale nuk kemi kërkuar asgjë më tepër veç asaj që na garanton Kushtetuta dhe lejojnë ligjet ekzistuese. Prej tërë kësaj ne nuk kemi fituar asgjë, edhe pse Kushtetuta na garanton. Ne nuk mund të hapim shkollat në gjuhën amtare, megjithëse ligji na i lejon.”<sup>1708</sup>

Por, Ferhat Draga, më shumë se për të tjera armiqësohet me “aleatët” e tij pse do ta kritikojë, por edhe do ta frenojë shpërnguljen e Shqiptarëve në Turqi, këtë objektiv shumë të rëndësishëm të politikës hegjemoniste të Beogradit. Krahas denoncimit që do t’ua bëjë militantëve të shtetit, të cilët veprojnë haptas për

---

<sup>1706</sup>Shih: Osmani, Jusuf: “Kolonizimi, reforma agrare dhe shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova 1918-1941”, II,III, Prishtinë, 2016

<sup>1707</sup> Shih gazetën “Hak”, 17 tetor 1923.

<sup>1708</sup> Po aty.

ta terrorizuar popullatën shqiptare, siç ishte Miliq Kërsta në rrethin e Istogut, për të cilin thotë se “i armatosur deri në dhëmbë vret sipas dëshirës”, Draga do të denoncojë edhe Reformën Agrare, e cila haptas përdorej si mjet për kolonizimin e Kosovës me Serbë dhe popujt e tjerë sllavë. “Ne nuk jemi kundër reformës agrare. Le të zbatohet ajo në ato vende ku ka pak popullsi. Konsiderojmë se së pari duhet t’u jepet tokë vendasve tanë, që janë bujq e nuk kanë mjaft tokë, e pastaj ç’tepron të sillen kolonët, bujq të vyeshëm, nëse është nevoja. Por në radhët e kolonëve që sillen tash, pjesa më e madhe prej tyre, nuk janë për bujqësi, si për shembull në Dukagjin, ku ka aso rastesh që koloni merr pushkën, lahutën dhe ulet nën hije, ndërsa tokën ia punojnë Shqiptarët nën presionin e “autoritetit” të pushkës. Ka raste kur Shqiptari e mbjell, e korr dhe e bën duaj, pastaj ia beh koloni i merr duajt dhe i çon në lëmë të vet. Të gjitha këto bëhen me qëllim të caktuar që të tronditet popullsia shqiptare dhe të shpërngulen”.<sup>1709</sup>

Draga do të protestojë me fjalët se “problemi i pakicave, në këtë rast i Shqiptarëve, po sjell rrjedhime të kobshme për ta. Tendenca që Shqiptarët të shkrihen, nuk është e mundur të realizohet. Shkrimja e kësaj popullate dhe shpërngulja nuk do të bëhet realitet kurrë”.<sup>1710</sup>

Këto dhe deklaratat e ngjashme të Ferhat Ali Dragës, si dhe shkrimet e vazhdueshme të gazetës “*Hak*” rreth krimeve të organizuara ndaj popullatës shqiptare në Kosovë, që bëheshin nën direktivat e shërbimeve speciale ushtarake dhe policore, të cilat megjithatë nuk mbeteshin pa jehonë në opinionin e brendshëm të vendit, por edhe në atë të jashtëm, bënë që “Xhemjeti”, por edhe drejtuesit e saj, Ferhat Draga dhe të tjerët, që nuk pajtoheshin me atë që ndodhte në Kosovë dhe pjesët e tjera të banuara me Shqiptarë, Radikalët dhe Demokratët (veçmas këta të parët që kontrollonin pushtetin), të fillojnë skenarin për shkatërrimin e “Xhemjetit” dhe likuidimin politik të Ferhat Ali Dragës dhe liderëve të tjerë, edhe pse ata, që nga fillimi i bashkëpunimit të detyrueshëm me këto parti, kishin fituar anatemën e “bashkëpunëtorëve” të Radikalëve, gjë që ua kishte ulur autoritetin te një pjesë e Shqiptarëve, të cilët i shihnin “vegla të tyre”.

Urdhri për rrënimin e “Xhemjetit” dhe të liderëve të tij, në radhë të parë të Dragës, erdhi nga Pashiqi, i cili kishte dërguar në Kosovë dhe Maqedoni emisarin e tij, Toma Popoviqin, që një pjesë të “Xhemjetit” nga radhët e fanatikëve myslimanë, të lidhur për klerin, ta bëjë për vete, duke e lidhur drejtpërdrejt me Radikalët. Natyrisht se kjo lidhje duhej të bëhej me premtime dhe disa favore që

---

<sup>1709</sup> “*Hak*”, nr. 689.

<sup>1710</sup> “*Hak*” nr. 693.

do t'u jepeshin atyre, ndërsa përçarja nga brenda, me akuza dhe kundër akuza të ndër-sjella midis tyre, të mbetej mjet i përhershëm. Meqë ndër Shqiptarë tashmë kishin filluar t'i fusin gishtat edhe faktorët e tjerë (veçmas Kroatët të cilët kërkonin aleatë kundër prirjeve gjithnjë e më të theksuara të politikës hegjemoniste serbe), Radikalët e Pashiqit po edhe Demokratët, kërkonin që këtë ta pengonin me çdo mjet. Kjo shtoi edhe më shumë përkushtimin e këtyre partive të rrënonin çfarëdo autoriteti midis Shqiptarëve, i cili sado pak do të denjonte që skenën politike jugosllave ta shfrytëzonte për këtë qëllim. Në këtë drejtim partitë politike serbe pajtoheshin plotësisht, dhe si do të shihet, u mbetej që t'i ndanin detyrat, që kjo të arrihej sa më shpejt dhe me mjete sa më brutale, në mënyrë që me rrënimin e autoriteteve shqiptare të arriheshin dy qëllime njëherësh: likuidimi nga skena politike i atyre që ishin jashtë mbikëqyrjes serbe dhe për t'i dëshpëruar Shqiptarët me çka ata, duke humbur çdo shpresë se mund të mbijetojnë disi duke iu bashkuar aleancave në vend kundër hegjemonizmit serbomadh, do të detyrohen të shpërngulen përfundimisht. Këtu, pra del në pah, ajo që më vonë do të dëshmohet fund e krye, se për hegjemonizmin serbomadh skena politike në Kosovë, Maqedoni dhe pjesët e tjera të Jugosllavisë, nuk ishte për qëllime politike, e aq më pak për të mirën e parlamentarizmit, por për t'u demonstruar dhuna me anën e së cilës aktrimi i demokracisë duhej të kthehet në mjet për përmbushjen e programeve nacionale hegjemoniste, të shprehura qysh nga "Naçertanja" e Garashanit për të arritur te elaboratet morbide që elita intelektuale serbe do t'i hartojë, siç ishte ai i Çubrilloviqit, që do të shfaqet pak më vonë në "Klubin Kulturor Serb", për të cilin u bë fjalë më parë.

Në të vërtetë, ky përcaktim, që pak më vonë do të bëhet shkaktar edhe i shkatërrimit të Jugosllavisë së Versajës, do të fillojë të sprovohet në Kosovë dhe Maqedoni dhe ndaj Shqiptarëve për t'u zgjeruar pastaj edhe ndaj të tjerëve (Kroatëve, Sllovenëve), siç do të jetë rasti edhe me likuidimin e liderit politik kroat, StjepanRadiçit, në parlamentin jugosllav. Kjo "mostër" do të fillojë me "Xhemjetin" dhe liderët e saj kryesorë, edhe pse ata gjatë gjithë kohës do të shfrytëzohen "si partnerë" koalicioni, por që do të rrëzohen, pikërisht ngase partitë unitariste dhe hegjemoniste serbe do të kuptojnë fare mirë se edhe në rrethanat e një "bashkëpunimi" të dhunshëm me këto parti, edhe në rrethanat e një sjellje vasale të tyre, kjo jo vetëm që nuk u shkonte përshtati, por bënte të kundërtën, ngaqë te Shqiptarët, siç do të konstatojë Çubrilloviqi në elaboratin e tij të njohur "Shpërngulja e Shqiptarëve" gjendja e mbijetimit edhe si të shtypur do të "rrisë vetëdi-

jen nacionaliste të Shqiptarëve e me të edhe irredentizmin si fenomen të pashmangshëm”.<sup>1711</sup>

Ky vlerësim dëshpërues, i cili politikën hegjemoniste serbe do ta drejtojë drejt hapave më radikalë, pra të zhdukjes së çështjes shqiptare me anën e dhunës shtetërore dhe të shpërnguljes në masë të tyre, siç do të veprohet në të vërtetë gjatë gjithë kohës, për Pashiqin dhe të tjerët, mund të kalonte paraprakisht nëpër disa shkallë: nga ajo e përdorimit të tyre për qëllime të partive politike serbe, siç do të ndodhë deri në vitin 1925, likuidimi i partive të tyre politike në tërësi dhe shkrirja e elektoratit shqiptar në partitë serbe, siç do të ndodhë nga vitit 1925 e deri në vitin 1938 dhe së fundi, përcaktimi për largimin e tyre të plotë nga çfarëdo animimi politik, siç do të ndodhë nga viti 1938 e deri në vitin 1941.

Megjithatë, Pashiqi dhe bashkëmendimtarët e tij, nga vitit 1925 ia dolën që të rrënojnë nga brenda “Xhemjetin”, edhe pse qysh më 1922 me ndërrimin e emrit në “*Organizata Myslimane e Serbisë së Jugut në Mbretërinë SKS*”, ia kishin imponuar karakterin fetar dhe identitetin turk duke e detyruar që këto t’i kutivojë vetëm brenda identitetit fetar dhe kombësisë turke, me çka duhej t’i përgatitej terreni shpërnguljes masive me anën e marrëveshjeve me Turqinë. Ky veprim, megjithatë, duhej të shoqërohej me masa të ashpra të terrorit shtetëror ndaj Shqiptarëve, në mënyrë që ato të kurorëzoheshin edhe me eliminimin dhe burgosjen e liderëve të kësaj partie. Paralajmërimin e këtij veprimi do ta bëjë gazeta “Hak”, e cila, po ashtu do ta përjetojë fatin e “Xhemjetit”. “Ka kaluar një decenie qysh se shkopi i oligarkisë radikale pa mëshirë ka rrahur e ndjekur çdo gjë që nuk kryqohet më në mënyrë radikale dhe nuk merr frymë sikundër bëjnë radikalët. Posaçërisht në kohën e fundit, ithtarët e radikalëve po armatosen për të vazhduar terrorin. Pushteti i radikalëve njihet për të keq, sepse shpërndahej prona shoqërore nga pushteti i saj, nxitej shovinizmi fisnor (popullor), ndiqeshin të gjithë njerëzit e ndershëm në anët jugore”.<sup>1712</sup>

Terrorin shtetëror të Radikalëve e vërteton edhe një letër e konsullit gjerman në Beograd, Wolfbeck që ia kishte dërguar ministrisë së jashtme gjermane, ku bëhet e ditur se para zgjedhjeve qeveria kishte filluar terrorin dhe se në të drejt-përdrejt ishin përfshirë Pashiqi dhe Pribiçeviçi. Aty thuhet se terrori i ashpër ishte evident sidomos në regjionin e Kosovës dhe të Dukagjinit.<sup>1713</sup>

I njëjti burim bën të ditur se terror po ushtrohej edhe ndaj këshillave të “Xhemjetit” nëpër qytete, me ç’rast shkatërrimin e tyre qeveria e arriti duke dety-

<sup>1711</sup> Më gjerësisht shih Čubrilović, Vasa: “*Iselavanje Arnauta*“, Beograd, 1937.

<sup>1712</sup> Shih gazeta “Hak”, nr 694.

<sup>1713</sup> Avramovski, Žarko: „*Diplomatski izveštaji*“, dokument 79, 85.

ruar udhëheqësit e tyre që të shpërngulën në Turqi. Kishte raste, si në Gjakovë, Pejë, Istok. Drenicë dhe të tjera, që ata shpallen kaçakë.<sup>1714</sup>

Që të shuhet “Xhemjeti”, ose siç quhej ndër Shqiptarë “Bashkimi”, Pashiqi vendosi që së pari të burgoset Ferhat Ali Draga. Draga u burgos më 21 janar 1925 me urdhrin e prefektit të Mitrovicës, i cili ia komunikoi vendimin personalisht. Atij iu bë një gjykim i shpejtë, kryesisht politik, që e shpalli “fajtor” dhe e dënoi me 20 vjet burg. Aktakuza e ngarkoi se gjatë Luftës së Parë Botërore kishte vrarë Serbë, por pas pak u amnistua nga mbreti bashkë me Bedri Pejanin. Ai u burgos edhe në vitin 1927, por prapë u lirua nga dënimi me “anën e faljes”. Pos Dragës u burgosën edhe disa persona me autoritet. Policia ndërmori masa të gjera bastisjeje edhe ndaj disa deputetëve shqiptarë, duke vënë në shënjestër autoritetet kryesore.<sup>1715</sup>

Edhe pse proceset gjyqësore kundër Ferhat Ali Dragës kishin për qëllim mënjanimin e tij nga politika, megjithatë ndryshimet e mëdha në skenën politike të vendit si dhe nevoja që aktorët e saj të luajnë me kartën e autoriteteve vendore, bëri që Draga sërisht të kthehet në jetën politike, por jo në plan të parë si deri atëherë, por këtë duke e bërë me inkuadrimit në jetën arsimore nëpërmes medreseve shtetërore, paçka se në to kultivohej “identiteti fetar islam” në gjuhën serbe.<sup>1716</sup>

Meqë, ishte referencë thujtë e të gjitha grupimeve politike në vend, të cilat ndryshonin formën, por jo edhe përmbajtjen, Draga “nga hija” ndikoi në këto raporte dhe madje disave edhe ua përcaktoi kahun. Në vitet e fundit, ai do t’i ndihmojë qeverisë së Stojadinoviçit të ketë sa më shumë mbështetës ndër Shqiptarë, meqë kjo kishte të bënte me kursin e tij, që ndryshonte nga ai tradicional i Beogradit te Franca, kah vendet e Boshtit, Gjermania dhe Italia.

---

<sup>1714</sup> Po aty.

<sup>1715</sup> Shih raportin e gazetës “Politika” më 1 shkurt 1925.

<sup>1716</sup> Është e njohur se midis dy luftërave botërore, nën pushtimin e Mbretërisë së Serbo-Kroate-Slllovene dhe asaj Jugosllave më pas, u mohojë e drejtas e arsimit në gjuhën e tyre amtare. Në mungesë të shkollave shqipe, fëmijët shqiptarë edukimin e tyre arsimor e merrnin në shkollat private fetare, përkatësisht mejtepet. Përveç mejtepeve, në territorin e Mexhlisit të Ulemasë në Shkup, vepronin edhe medrese private, siç ishte “*Medresja Atak*” në Gjilan, “*Medreseja Medah*” në Shkup, “*Medreseja Pirmaz*” në Prishtinë, “*Medreseja Gazi Ali Beu*” në Vushtri, “*Medreseja e Madhe*” në Gjakovë, “*Medreseja Mehmet Pasha*” në Prizren, “*Medreseja Haxhi Pllana*” në Ferizaj etj. Në vitin 1925, Qeveria e Beogradit, siç thuhej, për nevojat e “myslimanëve të Serbisë së Jugut” hapi Medresenë e Madhe “*Kral Aleksandri I-rë*”. Kjo shkollë financohej nga shteti dhe si e tillë pati statusin e njëjtë me shkollat e tjera të mesme shtetërore. Me ndryshimin e Kushtetutës së “Bashkësisë Fetare Islame” të vitit 1936, në Shkup hapet një medrese me emrin “*Medreseja e Reformuar Gazi Isa Beu*”. Nga viti 1937, me këtë insitucion të lartë fetar udhëhoqi krahu kombëtar shqiptar në krye me Ferhat Dragën, Sherif Langun, Mulla Idriz Gjilanin, Bedri Hamidin, Autallah ef. Kurtishin e të tjerë. Për dallim nga Medreseja e Madhe, kjo Medrese edhe pse veproi shkurt (pesë vjet), nxori një numër të konsiderueshëm të kuadrove, që më vonë do të jenë në ballë të lëvizjes kombëtare shqiptare siç ishin: Azem Marana, Hilmi Shehu, Abdylqerim Saiti, Ramadan Agushi, Idriz Idrizi e shumë e shumë të tjerë, të cilët, menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, themeluan Organizatën Nacional Demokratike Shqiptare. (Shih: Lita Qerim: “*Territoret lindore shqiptare 1912-1920*”, Shkup, 2016, faqe 36-39).



Në këtë atmosferë u mbajtën zgjedhjet e shkurtit të vitit 1925, në të cilat qeveria doli e bashkuar me “bllokun nacional” të përbërë prej Radikalëve dhe Demokratëve, që për moto kishte “luftën kundër antishtetërorëve”, që e përkthyer në realitetin shoqëror dhe politik do të thoshte luftë “kundër Shqiptarëve”. Kjo bëri që ditën e zgjedhjeve në Kosovë të lëshohet në veprim ushtria dhe xhandarmeria, e cila duhej të siguronte shumicën qeverisë. Kështu gjatë zgjedhjeve nuk u bënë vetëm burgosje të autoriteteve shqiptare, por u burgosën edhe anëtarët e familjeve të tyre.<sup>1717</sup>

Gjendja e shtetdrethimit praktik që u vendos në Kosovë gjatë zgjedhjeve të vitit 1925, ku fituan forcat më ekstreme serbomëdha: radikalët dhe republikanët, bëri që ajo të përhapet edhe në pjesët e tjera të vendit. Blloku nationalist-hegjemonist serb tashmë ndjehej i rrezikuar nga çfarëdo demokratizimi të vendit, andaj, modelin e Kosovës nisi ta bart edhe në pjesët e tjera, sidomos në Kroaci, ku po krijoheshin bërthama e cila mund ta rrëzonte hegjemonizmin serbo-madh. Andaj, ishte e natyrshme që këto zhvillime të çojnë edhe te atentati ndaj Stjepan Radiçit, kryetarit të “Partisë Katundare Kroate” në parlamentin jugosllav. Duke shfrytëzuar këtë gjendje që ta promovojë një diktaturë monarkike, mbreti shpërndau Kuvendin dhe më 6 janar 1929 anuloi Kushtetutën e vitit 1921. Ishte pra një grusht-shtet që solli në pushtet mbretin i cili u kthye edhe në diktator. Në të vërtetë, mbreti me këtë akt, nuk bëri tjetër pos realizoi dëshirën e borgjezisë hegjemoniste serbe që në vend të Jugosllavisë homogjene, të shpallë Serbinë homogjene.<sup>1718</sup>

Ndërsa, sa i përket Kosovës dhe Maqedonisë, diktatura e 6 janarit solli një gjendje edhe më të rëndë. Rrethanat politike dhe shoqërore u bënë edhe më të vështira, ndaj popullsisë shqiptare ushtrohej një politikë shkombëtarizuese më e fuqishme, ndërkohë që torturat ndaj saj u shtuan, kolonizimi dhe shpërngulja u bënë edhe më në masë.<sup>1719</sup>

Diktatura monarkike, në njëfarë mënyre, por nën petkun e parlamentarizmit, vazhdoi edhe pasi që më 3 shtator mbreti shpalli formalisht Kushtetutën. Në përputhje me të, më 8 nëntor 1931 u shpallën zgjedhjet parlamentare për kuvendin jugosllav. Sipas ligjit Kosova ishte ndarë në katër zona votimi dhe mund të jepte 15 deputetë. Krahasuar më herët e kaluara, kur ajo mund të jepte deri 22 deputetë, këtë herë asaj i ishte rrudhur dukshëm përfaqësimi në Parlament.

---

<sup>1717</sup>Čulinović, Ferdo: „Jugoslavija između dva rata“, Zagreb, 1961.

<sup>1718</sup>Novaković, Kosta: „Nacionalizam i srbizacija Kosova“, Vjenë, 1931.

<sup>1719</sup>Bajrami, Hakif: “Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë më 1918-1941”, Prishtinë, 1981, faqe 247.

Megjithatë Kushtetuta e re, ndikoi në ndryshimet në skenën politike, jo gjithaq në aspektin cilësor, por më shumë në atë formal, kur aktorët e deriatëhershëm Radikalët dhe Republikanët do të humbin ndikimin që kishin, ndërsa hapësirën e tyre do ta zënë partitë që dirigjoheshin nga oborri mbretëror. Kështu, në skenë dolën “*Partia Nazionale Jugosllave*” (Jugoslovenska nacionalna stranka). Krahas partisë qeveritare, doli edhe “*Partia Popullore Jugosllave*” (Jugoslovenska narodna stranka), e cila do të duhej të paraqiste njëfarë opozite, por që për shumë-çka mbeti partnere e saj, meqë ajo udhëhiqej nga Ministria e Punëve të Brendshme, pra nga policia. Megjithatë, kjo pari tubonte rreth vetes milionerë dhe kapitalistë, të cilët përqendroheshin te planet ekonomike.

Pas zgjedhjeve parlamentare të nëntorit 1931, të cilat sollën në pushtet bllokun monarkist, i cili vazhdoi diktaturën nën farsën e parlamentarizmit, erdhën edhe ato të vitit 1935, ku pati gjithsej katër lista: ajo e bllokut mbretëror me listën qeveritare të kryeministrit Jevtiq, ajo e opozitës së bashkuar e cila përfaqësohej nga slloveni Maçek, lista e tretë përfaqësohej nga “pashiqasit”, pra radikalët e dikurshëm, që kishin humbur hapësirën që kishin, por e ruanin ndikim në qarqet e caktuara hegjemoniste serbe, ngase ata edhe më tutje ishin militantë të politikës së shpërnguljes së Shqiptarëve në Turqi, çetnikët e të cilëve vepronin edhe më tutje në Kosovë nën direktivat e policisë së Beogradit dhe të armatës. Lista e fundit ishte ajo e “Zborit”, e cila përfaqësohej nga kroati Lotiq, me ide fashiste. Të gjitha këto lista u paraqitën në të gjitha rrethet e Kosovës.<sup>1720</sup>

Në këto zgjedhje, siç pritej fitoi partia qeveritare, pra ajo mbretërore, e cila fitoi numrin e duhur të deputetëve për të dominuar edhe jetën parlamentare pa ndonjë shqetësim të madh, që mund t'i vinte nga kuvendi. Në parlamentin e ri hynë tetë deputetë shqiptarë të gjithë nga radhët e partisë qeveritare: (Xhemajl A. Limani, nga Prizreni, Ramadan F. Ramadani nga Podguri, Behlul A. Haliti nga Gora, Shaqir Halili nga Llapi, Mustafa Dërguti nga Podrimja, Mahmut Begu nga Peja, Zeqir Zeqiri nga Gjilani dhe Sherif Beqir Voca nga Vuçitërna).

Kjo legjislaturë, megjithatë, do të mbahet mend për një ndryshim të kursit të politikës jugosllave nga ajo tradicionale, që ishte e kthyer nga Franca, te ajo e Boshnit, kah Gjermania dhe Italia. Kjo kthesë u mundësua pasi që Knjaz Pavli shtyu Milan Stojadinoviqin që ta rrëzojë qeverinë në mbledhjen e Këshillit Ministror.

Qeveria e Stojadinoviqit, vendosi që zgjedhjet e ardhshme të mbahen në dhjetor të vitit 1938. Në planin politik thuhet asgjë nuk ndryshonte. Blloku qe-

---

<sup>1720</sup>Čulinović, Ferdo: „Jugoslavija između dvar rata“, Zagreb, 1961, faqe 98.

veritar ishte ai që lidhej me oborrin mbretëror që përkrahej nga politika serbe, ai i opozitës me Maçekun, i cili kërkonte ndërrimin e kushtetutës dhe federalizmin e vendit, gjë që kishte përkrahjen e popujve të tjerë, të cilët, po qe se do të bashkoheshin mund ta fitonin shumicën, dhe forca e tretë ishte “Zbori”.

Në këtë konstelacion politik bie në sy se Shqiptarët do të mundohen që të manovrojnë rreth partisë së pushtetit, pra me Stojadinoviçin, të cilit do t’i kërkohet që si kusht për t’u përkrahur partia e tij të ndalonte shpërnguljen e Shqiptarëve në Turqi. Ndonëse pa parti politike, sërish bie në sy Ferhat Ali Draga, në rolin e një autoriteti tashmë të pranuar shqiptar në përmasa të vendit, i cili tashmë si kryetar i Vakëfit të Shkupit, shfaqet me dy memorandume, të cilat do t’ia dërgojë Stojadinoviçit, i cili do të tregojë “mirëkuptim” për to, por çështjen për shqyrtim do t’ia autorizojë boshnjakut Mehmet Spaho, që e kishte në kabinet. Bëhet e ditur se Draga bashkë me autoritet e tjera vendore dhe me klerin islam do të mbështesin partinë e Stojadinoviçit, e cila do të fitojë shumicën e votave në Kosovë dhe pjesët e tjera të banuara me Shqiptarë. Kështu lista e tij në Kosovë fitoi 226.716 vota, ndërsa lista e Maçekut 74.977. Me këtë rast, nga Kosova mandatin e deputetit e fituan 11 Shqiptarë, që të gjithë kandidatë të JRZ (partisë së Stojadinoviçit).<sup>1721</sup>

Edhe pse i fitoi zgjedhjet bindshëm, ndonëse me manipulime, nën trysinë e ngjarjeve ndërkombëtare të cilat po çonin te forcimi i fashizmit dhe paralajmërimet e një krize të re botërore, pra për të parandaluar një ndikim të tyre më të madh në planin e brendshëm, pallati mbretëror, pra politika serbe e Beogradit, iu kthye një marrëveshjeje me Kroatët, të cilët kërkonin federalizmin e brendshëm, si kusht për të vazhduar ruajtjen e shtetit të përbashkët. Mbreti solli në pushtet Dragisha Cvetkoviçin, i cili për partner ndër Kroatë gjeti Vladimir Maçekun, me të cilin u arrit marrëveshja për federalizmin e vendit, pra për krijimin e banovinës (krahinës) kroate në kuadër të nëntë banovina në gjithë vendin. Në tri këto banovina (të Zetës, Moravës dhe të Vardarit, komform organizimit të deritani-shëm të qarqeve, u shkapërderdhën viset shqiptare të Kosovës dhe të Maqedonisë). Ky veprim i Beogradit, kënaqi bllokun kroat, por nuk e dobësoi pozitën e Serbëve, siç pritej dhe shpresohet nga Shqiptarët dhe popujt e tjerë të shtypur nga hegjemonizmi serb.

Faktori shqiptar, edhe pse nuk do të ketë të drejtën që të krijojë parti të veten, pas aneksimit të Shqipërisë nga Italia dhe futjes së Gjermanëve në Poloni,

---

<sup>1721</sup> Po aty.

pra nën trysninë e këtyre ngjarjeve që kishin filluar të ndryshonin skenën politike europiane, paksa do të lirohet nga dhuna e brendshme që ushtrohej ndaj saj në vazhdimësi. Madje, tërheqja zyrtare e Turqisë nga ratifikimi i konventës me Beogradin për shpërnguljen e turqve dhe myslimanëve (Shqiptarëve) nga Kosova dhe viset e tjera të banuara me Shqiptarë, këtij procesi ia ndali turrin dhe në disa pjesë edhe e ndali fare.

Në këto zhvillime prapë del në plan të parë Ferhat Ali Draga, i cili si kryetar i Vakufit të Shkupit përpiquej që të ruante rolin e autoritetit kryesor rreth të cilit sillleshin që të gjitha përvijimet politike dhe shoqërore të Shqiptarëve.<sup>1722</sup> Kështu, nën drejtimin e tij, paria shqiptare do të përpiqet që të organizohet, si pari shqiptare, por që këtë do ta bënte nën ombrellën e partisë qeveritare (JRZ), meqë vlerësohej se në ato rrethana, rreth këtyre çështjeve, ishte më e dobishme një bashkëpunim me Beogradin se sa ndonjë ngarendje deklarative pas federalizmit kroat, i cili kishte hesapet e veta. Gjatë një takimi të Ferhat Dragës me krerët shqiptarë (Iliaz Agushin, Qerim Zenën, Jusuf Imerin, Sherif Vocën, Adem Marmellakun, Jahja Dacin, Sadik Kurtin dhe Asim Luzhën) në gjysmën e dytë të vitit 1939 do të bisedohet konkretisht që blloku qeveritar mbretëror të pranojë legjitimitetin e grupimit shqiptar brenda tij.

Fillimi i Luftës së Dytë Botërore si dhe zhvillimet në të cilat bota tashmë po ndahej në dy blloqe: në atë të Fuqive të Boshtit dhe të kundërshtarëve (Britanisë së Madhe, SHBA-ve dhe Francës), Beogradin do ta afrojnë gjithnjë e më shumë kah Boshti. Jugosllavia, e cila nga viti 1935 kishte hyrë në disa biseda të fshehta për një pazar të mundshëm me Italinë rreth copëtimit eventual të Shqipërisë dhe ndarjes së re të sferave të interesit në Ballkan, tashmë ishte shumë pranë një lidhjeje të drejtpërdrejtë me këto vende, meqë Stojadinoviçi, fillimisht dhe pas tij qeveria Cvetkoviçi-Maçek shihte interesat e saj te Boshti. Për Beogradin, madje, aneksimi i Shqipërisë nga Italia paraqiste një shans, por edhe kërcënim njëherësh që t'i bashkohej këtij Boshti. Shansi kishte të bënte që me Italinë të arrinte një marrëveshje për ndarjen e mëtutjeshme të hapësirës shqiptare sipas interesave të tyre, ndërsa kërcënimi kishte të bënte me atë se mospranimi i paktit me Boshtin do të thoshte krijim i Shqipërisë së Madhe.

---

<sup>1722</sup> Veprimtaria e Ferhat Ali Dragës në jetën politike të vendit, sidomos pas zgjedhjeve të vitit 1937, lidhet me atë të Vakufit të Shkupit në kuadër të Bashkësisë Fetare Islame në Shkup, me ç'rast ai u zgjodh në krye të BFI-së në Shkup, prej nga, duke pas prapa edhe klerin islam, hyri në marrëveshje me qeverinë e Stojadinoviçit. (Shih: Bajrami, Hakif: *"Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë më 1918-1941"*, Prishtinë, 1981; Osmani, Jusuf: *"Kolonizimi, reforma agrare dhe shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova 1918-1941"*, I, II, III, Prishtinë, 2016; Mitrović, Živan: *"Srpske političke stranke"*, Beograd, 1939)

Sigurisht se do të jetë kërcënimi ai që do ta detyrojë Beogradin që zyrtarisht, në fillim të vitit 1941 t'i bashkohet Paktit Trepalësh, të cilin qeveria Cvetković-Maçek do ta nënshkruajë në Berlin më tre mars të atij viti.

Borgjezia serbe dhe kroate, pra e djathta, do të detyrohet të pranojë trysninë fashiste, ndërkohë që e majta e vendit, e organizuar nga e djathta europiane (në radhë të parë Britania e Madhe), e cila do të vërë në veprim gjithë spektrin majtist në krye me komunistët jugosllavë, që kishin vepruar për vite në ilegalitet (që nga shpallja e “Obznanës” në vitin 1921), të rrënojnë Paktin Trepalësh dhe me këtë të sjellin një situatë tjetër në vend, që do t'i paraprijë shkatërrimit të Jugosllavisë së Versajës, i cili do të pasojë pas sulmit gjerman më gjashtë prill 1941, kur pas gjashtë ditësh bombardimesh Beogradi do të kapitullojë.

## KAPITULLI ITRETË

### FILLIMET E LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

#### RRËNIMI I JUGOSLLAVISË SË VERSAJES DHE BASHKIMI I PËRKOSSHËM SHQIPTAR

Shkatërrimi i Jugosllavisë së Versajës solli realitete të reja politike në një hapësirë, e cila, nga Kriza Lindore e këndeje dhe, veçmas luftërat ballkanike dhe ajo botërore, kishte qenë pjesë e interesave të fuqive të mëdha evropiane, mbi të cilat ishin krijuar shtetet që dolën nga pushtimi shumëshekullor osman. Pjesa që më së shumti ishte copëtuar dhe kishte shërbyer për kusuritje ishte ajo e etnisë shqiptare. Shkatërrimi i Jugosllavisë së Versajës e kthente në fokus të Fuqive të Boshitit hapësirën shqiptare si një hisë të rëndësishme, edhe nga shkakut se Italia fashiste, pjesë e Boshit, qysh në vitin 1939, me futjen e mbretërisë shqiptare (të Zogut) nën ombrellën e Perandorisë Italiane, në rrethanat e reja, mund të kërkonte që pjesët tjera shqiptare që i mbante Jugosllavia e Versajës (Kosova dhe Maqedonia Perëndimore), në emër të një Shqipërie të Madhe, t'i bashkoheshin perandorisë italiane. Ngjashëm mund të kërkonte edhe Bullgaria, e cila, po ashtu, pretendonte që si aleate të zgjeronte hapësirën e saj në drejtim të Serbisë, Kosovës dhe veçmas Maqedonisë në frymën e shtetit bullgar të Shën Stefanit.

Këto dilema dhe të ngjashme fitonin edhe më shumë në peshë kur dihej se shkatërrimi i Jugosllavisë së Versajës, më shumë ishte pjesë e ndëshkimit të saj pse ishte larguar nga Pakti Trepalësh me Boshtin, që e kishte nënshkruar më 27 mars me qeverinë e Beogradit se sa pjesë e ndonjë koncepti të mëhershëm se ajo duhej të shkatërrohej për t'u krijuar realitetet e reja në hapësirën e saj (nga shteti i pavarur kroat, Serbia e Nediqit e deri te “Shqipëria e Madhe”).

Megjithatë, bëhet e ditur se Hitleri që në mars 1941 e kishte bërë planin përpuhshimin dhe ndarjen e Jugosllavisë. Ky plan përmbahej në direktivat e përkohshme për ndarjen e Jugosllavisë, në tri zona: atë gjermane, italiane dhe atë bullgare. Krahas formimit të shtetit të lirë kroat, edhe territori i Serbisë “së vjetër” vihej nën admini-

tratën ushtarake gjermane. Zbatimi i këtij plani ishte shpallur më 12 prill 1941 nga kryeshefi i Shtabit të Komandës Supreme të ushtrisë gjermane, gjenerali Keitel.<sup>1723</sup>

Edhe pse në parim ishte marrë vendimi që një pjesë e madhe e tokave shqiptare t'i bashkoheshin "Shqipërisë së Madhe", të cilën duhej ta drejtonte Italia, megjithatë midis Berlinit e Romës u shfaqën dilema rreth çështjes së kufijve. Kjo bëri që rreth kësaj pune të mbahet një takim urgjent në Vjenë, më 21 dhe 22 prill 1941 midis ministrit të jashtëm gjerman, von Ribentrop e atij italian, Kontit Çiano. Çiano kishte kundërshtuar kërkesat maksimaliste territoriale të Bullgarëve në drejtim të Maqedonisë edhe Kosovës. Italianët përfaqësonin qëndrimin që Bullgarëve t'u jepeshin sa më pakë toka shqiptare, meqë vetëm ashtu fitohej besimi i Shqiptarëve si partnerë të ardhshëm të rëndësishëm në rajon, ndërkohë që një Bullgari e Madhe dëmtonte këtë koncept. Meqë Bullgaria iu kishte bashkuar Paktit, edhe ndaj kërkesave të tyre duhej pasur kujdes. Kjo bëri që edhe atyre t'u jepej një pjesë e rrethit të Gjilanit, Vitia, një pjesë e Zhupës së Sirinikut dhe rrethi i Kaçanikut. Më vonë, në janar 1942 zona bullgare zgjerohet edhe me Podujevën, ndërsa më 17 janar 1943 me Mitrovicën e Vuçitërnën.<sup>1724</sup>

Pjesa tjetër ndahej midis Italisë dhe Gjermanisë. Kështu, në Vjenë u caktua vijja e demarkacionit ndërmjet Gjermanisë dhe Italisë (nga drejtimi i Vincit në Slloveni, nëpër Leskovien e Plitivicës e nëpër Udbine dhe Donji-Lapac në Livno, Prejnj, Bjellashnicë) - Priboj mbi Lim - Nova-Varosh – Sjenicë - Novi-Pazar - Mitrovicë – Prishtinë. Sipas kësaj ndarjeje, Rrafshi i Dukagjinit dhe pjesa më e madhe e Kosovës i takuan protektoratit shqiptar italian. Tri rrethe: Mitrovica, Vuçitërna e Podujeva i takuan zonës gjermane të okupacionit, përkatësisht Serbisë së Nediqit. Gjermanët ishin të interesuar të mbanin xeherorët e Kosovës dhe hekurudhat që lidhnin Beogradin me Selanikun, ndërsa për të tjerat mund të bisedohej me aleatët.

Për pjesën e Kosovës, të Rrafshit të Dukagjinit dhe të Maqedonisë që hyri në përbërjen e protektoratit italian të quajtur "Shqipëri e Madhe", në verën e vitit 1941 u formua "*Komisariati Civil për Kosovën, Dibrën e Strugën*". Në krye të tij ishte Komisari i Lartë, Fejzi Alizoti, që kishte rangun e ministrit të qeverisë së Tiranës. Administrata u konstituua sipas asaj në Shqipëri, përkatësisht në Itali. Në dhjetor të atij viti, qeverisjen e këtyre viseve e mori Ministria e Viseve të Çliruara në Tiranë, e cila u suprimua në shkurt 1943. Në këto pjesë u formuan prefekturat e Prishtinës, Prizrenit, Pejës dhe Dibrës e më vonë edhe ajo e Tetovës. Prefekturës së Pejës iu

---

<sup>1723</sup>Čulinović, Ferdo: „*Okupatorska podjela Jugoslavije*“, Beograd, 1970, faqe 523.

<sup>1724</sup>Po aty, faqe 524.

bashkuan edhe rrethet e Plavës e Gucisë, Rozhajës e Tutinit, Istogut dhe Drenicës. Rrafshi i Dukagjinit dhe pjesa e Kosovës në zonën italiane të okupacionit përfshinte rreth 500 mijë banorë. Shqiptarët e këtyre viseve, me vendimin e qeverisë së Tiranës, më 18 tetor 1941, automatikisht u bënë nënshtetas të Shqipërisë fashiste.

Pas bashkimit, Italia dëshironte që edhe Kosova dhe viset e tjera të shfaqeshin sa më shpejt me petkun fashist. Kështu, “*Partia Fashiste e Shqipërisë*”, e formuar më 2 qershor 1939 në Tiranë, nisi t’i hapë degët e saj në Prishtinë, Prizren, Pejë dhe qytetet e tjera shqiptare. Ministria e Arsimit e Shqipërisë u dha udhëzime shkollave, sipas të cilave ato kanë për detyrë “përhapjen e irredentizmit shqiptar dhe arsimimin në frymën e re”.<sup>1725</sup>

Për ndryshim nga zona gjermane dhe bullgare e okupacionit, ku si do të shihet, pati shumë vështirësi dhe mospajtime të Shqiptarëve me rrethanat në të cilat u vunë, veçmas në zonën e pushtuar nga Bullgarët. Në zonën italiane, nxitej jeta ekonomike dinamike: hapeshin punë, vazhdonte shfrytëzimi i xeheroreve, ngjallej tregtia me mallra të konsumit të gjerë, me drithëra etj. Që të përfitoheshin bejlerët, pushteti i Tiranës lejoi përtëritjen e marrëdhënieve çifligare.

Në Prizren u vendos selia e Komisarariatit të Lartë dhe Shtabi i Forcave Italiane. Ky qytet, në të cilin u vendosen edhe përfaqësitë e shumta tregtare, ekonomike, administrative dhe kulturore, përjetoi një shkallë dinamike të zhvillimit dhe u bë njëri ndër qytetet më të zhvilluara shqiptare.

Por, gjendja nuk ishte e tillë në tri rrethet e Kosovës, që hynë nën zonën gjermane të okupimit, të cilat, së bashku me Novi-Pazarin, përbënin prefekturën e Kosovës me qendër në Mitrovicë, e cila, formalisht bënte pjesë në Serbinë gjermane të Nediqit dhe përfshihej në *Banovinën e Drinës* me seli në Uzhicë. Grupi i kombësisë shqiptare e kishte në Banovinën e Drinës të besuarin e saj në rangun e ndihmësbanit, i cili merrte pjesë në vendosje për të gjitha çështjet që kishin të bënin me Kosovën.<sup>1726</sup>

Sipas dekretit të “Këshillit të Komisarëve”, që nxori Milan Aqimoviqi më 6 gusht 1941, Prefektura e Kosovës, në krye të rretheve (nënprefekturave) kishte nënprefektët, pjesëtarë të shumicës (Shqiptarë), kurse zëvendës të tyre ishin pjesëtarët “e pakicës prej së paku 25%” (do të thotë Serbë), nëpunësit e tjerë ishin nga radhët e Shqiptarëve dhe Serbëve në përpjesëtim me raportin e tyre, numrin në rrethe (nënprefektura). Kjo vlente edhe për xhandarmërinë. Emërimin e bënte

---

<sup>1725</sup> Hadri, Ali: “*Kosovo i Metohija u Kraljevini Jugoslavije*”, Istorijски glasnik, Beograd, 1967, faqe 62-65.

<sup>1726</sup> Rajović, Radošin: “*Autonomia e Kosovës*”, Prishtinë, 1987, faqe 198.



“pushteti administrativ serb në Beograd”, kurse emërimi i personelit të Shqiptarëve bëhej “në pajtim me udhëheqësin e grupit të kombësisë shqiptare”.<sup>1727</sup>

Krahas të ardhurave financiare, të administruara në përputhje me nevojat e prefekturës së Kosovës të përfshira në zonën okupuese gjermane, Shqiptarët kishin të drejtën e shkollave shqipe, por i obligueshëm ishte edhe mësimi i gjuhës serbe. Personeli arsimor në shkollat shqipe emërohej nga Ministria e Arsimit me propozimin e udhëheqësit të grupit të kombësisë shqiptare.<sup>1728</sup>

Në Qarkun e Kosovës, ishte stacionuar një regjiment i ushtrisë gjermane, nga përbërja e Divizionit 717 të këmbëorisë, i cili qendren e kishte në Mitrovicë. Por, në Qarkun e Kosovës ishte formuar edhe “*Xhandarmëria shqiptare*”, nën komandën e kolonel Bajazit Boletinit, oficer i ish ushtrisë jugosllave, e përbërë prej rreth një mijë pjesëtarësh. Aty ishin edhe njësitë e “*Rojës shtetërore serbe*”, në të cilat më shumë se dy të tretat ishin Shqiptarë, dhe të cilat një kohë ishin nën komandën e Ali Dragës, të birit të Ferhat Dragës, udhëheqësit të “*Grupit të Kombësisë Shqiptare*”. Aty ishin edhe aradhet çetnike të Kosta Peçancit, të cilat kishin njësi “vullnetarësh” të shpërndara nëpër katunde bashkë me formacione të tjera.<sup>1729</sup>

Për të luftuar që Kosova dhe viset e tjera të pushtuara nga ish Jugosllavia, tani të shpërndara në tri zona okupuese, t’i bashkoheshin sa më shumë një tërësie (me këtë rast Shqipërisë së Madhe), në maj të vitit 1941 në Kosovë kishte kaluar Komiteti “*Mbrojtja Kombëtare Shqiptare e Kosovës*”, me në krye Bedri Pejanin - kryetar, Rexhep Mitrovicën – nënkryetar e Xhelal Mitrovicën - sekretar, në përbërje të të cilit gjendeshin edhe Ibrahim Gjakova, Tafil Boletini, Qerim Begolli, Shaqir Curri, Qemajl Prishtina, Rexhep Krasniqi, Tahir Zajmi e të tjerë.<sup>1730</sup>

Një numër i anëtarëve të Komitetit u ndalën në Prizren, kurse pjesa tjetër, në krye me Bedri Pejanin, shkoi në Mitrovicë, në mënyrë që atje të vepronte që edhe kjo pjesë e Kosovës të përfshihej në “Shqipërinë e Madhe”. Në Mitrovicë, Komiteti filloi botimin e gazetës “Kosovari”, e cila bënte thirrje të vazhdueshme që edhe kjo pjesë t’i bashkohej shtetit të përbashkët shqiptar nën protektoratin italian.

Tema e “bashkimit shqiptar”, megjithatë, ndau Komitetin në dysh. Nëproitalianë (Ferhat Draga dhe Bedri Pejani, të cilët angazhoheshin që kjo pjesë e Kosovës

---

<sup>1727</sup> Po aty, faqe 200.

<sup>1728</sup> Miletić, Antun: “*Kosovo iz aspekta okupacione uprave Vermahta u Srbiji 1941-1944*”, Kosova – Kosovo, Prishtinë, nr 4/1975, faqe 163-168.

<sup>1729</sup> Hadri, Ali: “*Kosovo i Metohija u Kraljevini Jugoslaviji*”, Beograd, 1967, faqe 54-57.

<sup>1730</sup> Komiteti “*Mbrojtja Kombëtare shqiptare e Kosovës*” ripërtëriu punën në verën e vitit 1939 me lejen e qeverisë së Shefqet Vërlacit. Ata ishin të gatshëm që në “rast të krizës jugosllave”, e cila, dihej se do të shkonte së shpejti drejt rrënimit të shtetit të dhunshëm, të futeshin në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare për t’i rikthyer ato në përbërje të Shqipërisë.

të ndahej nga “shteti” i Nediqit e t’i bashkohej Shqipërisë) dhe në progjermanë (XhaferDeva, i cili më shumë e dëshironte autonominë nën Gjermaninë me anën e së cilës mund të arriheshin hap pas hapi aspiratat kombëtare të Shqiptarëve, që sipas tij kërkonin një mbështetës të fuqishëm, siç ishte Gjermania, e cila bashkimin e Shqiptarëve do ta shohë edhe si interes të saj për një aleat të fuqishëm rajonal).<sup>1731</sup>

Për t’i pajtuar këto dallime, do të përkujdeset “*Lidhja Kombëtare Shqiptare*”, e themeluar në Mitrovicë me në krye Ali Dragën, i cili, si prijës i “Grupit Shqiptar” përfaqësonte Shqiptarët para pushtetit okupues gjerman. Sekretar i “Lidhjes” ishte Vehbi Frashëri, i biri i Mehdi Frashërit, ish kryetarit të qeverisë mbretërore shqiptare dhe kryetarit të mëvonshëm të Këshillit të Regjencës së Shqipërisë (pas kapitullimit të Italisë).

Kështu do të jetë së paku deri nga vjeshta e vitit 1943 kur do të kapitullojë Italia fashiste dhe vendin e saj do ta zënë forcat gjermane, të cilat sapo të futen në viset shqiptare do të deklarojnë se vijnë si miq të Shqiptarëve që të sigurojnë mbrojtjen dhe vazhdimësinë e shtetit shqiptar.

## REALITETET E REJA SHQIPTARE DHE LIDHJA IDEOLOGJIKE ME KOMUNISTËT JUGOSLLAVË

Kontaktet e para të komunistëve jugosllavë me grupet komuniste shqiptare do të fillojnë nga gjysma e dytë e vitit 1939 dhe ato do të nisin nga dy drejtime: nga Mali i Zi dhe nga Kosova. Nga Mali i Zi, i angazhuar për lidhje me komunistët Shqiptarë, do të caktohet fillimisht Billazho Jovanoviq dhe pak më vonë edhe Ivan Millutinoviq, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë dhe i besueshëm i Titos. Ndërsa nga Kosova do të jenë Milladin Popoviqi dhe Dushan Mugosha, kolonë nga Peja, që të dy udhëheqës të organizatës komuniste të Kosovës, e cila asokohe numëronte rreth njëqind e pesëdhjetë anëtarë, me vetëm dy Shqiptarë në radhët e udhëheqjes: Ramiz Sadiku dhe Ali Shukriu - të rekrutuar si studentë të Beogradit,<sup>1732</sup> pa mbështetje të bazës partiake nga radhët e Shqiptarëve. Në ato rrethana komunistët jugosllavë për qëllime të caktuara spekulonin me anëtarësi shqiptare në Kosovë shpesh duke falsifikuar lista dhe emra që i sajnin në Beograd dhe gjetiu.<sup>1733</sup>

<sup>1731</sup>Miletić, Antun: „*Kosovo iz aspekta okupacione uprave Vermahta u Srbiji*“, Prishtinë, 1975, faqe 163-198.

<sup>1732</sup>Vukmanoviq - Tempo, Svetozar: “*Memoari*” I, II, Beograd-Zagreb, 1985.

<sup>1733</sup>Po aty.

Edhe pa bazë partiake në Kosovë, emisarët jugosllavë në Shqipëri do t'ia dalin me të shpejtë të vejnë “lidhje miqësore dhe vëllazërore”, por gjithnjë mbi baza klasore, me përfaqësuesit e grupeve komuniste dhe majtiste shqiptare për t'i përgatitur paraprakisht që t'u nënshtroheshin rregullave jugosllave të organizimit. Këtu baza partiake e Shqipërisë nuk duhej të përfshinte Kosovën, meqë, sipas jugosllavëve, atje tashmë ekzistonte organizimi partiak vendor nga viti 1939, fillimisht nën mbikëqyrjen e Komitetit Krahinor të Bokës dhe të Malit të Zi, i cili në Konferencën e Katërt Vendore të PKJ-së në Zagreb do të lidhet drejtpërdrejt me Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Madje, Milladin Popoviqi dhe Dushan Mugosha do të paraqiten në Shqipëri si kuadro partiake nga Kosova. I pari në funksionin e sekretarit organizativ të Komitetit Krahinor të PKJ për Kosovë e Metohi dhe njëherësh anëtar i KQ të PKJ-së. Ndërsa i dyti anëtar i Komitetit Krahinor.<sup>1734</sup>

Vërehet, pra, se edhe ashtu si ishte organizuar ajo që shfaqej si organizatë partiake e Kosovës, kryesisht e përbërë nga Serbët dhe Malaziasit dhe fillimisht vetëm me dy Shqiptarë dhe disa kandidatë partie, do të jetë e lidhur me Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë dhe jo me Serbinë. Ky fakt ka rëndësi për të treguar qëndrimet joparimore të komunistëve jugosllavë, por edhe të atyre shqiptarë nga Shqipëria, kur në fund të luftës, në vend se logjika e këtij organizimi partiak të ndiqte edhe atë të organizimit politik dhe institucional - me çka Kosova, së paku, do të duhej të kishte statusin e njësisë federative bashkë me të tjerat - dhunshëm do t'i përcaktohet tutela e Serbisë, siç do të ndodhë në Kuvendin e Këshillit Nacionalçlirimtar në Prizren nga 6-10 korrik 1945.<sup>1735</sup>

Sidoqoftë dhe pa as më të voglin kundërshtim, komunistët shqiptarë do të pranojnë “udhëzimin” e komunistëve jugosllavë që të respektohej organizimi i ndarë partiak i Shqiptarëve në Shqipëri dhe në Kosovë, organizim ky që pastaj do të ndjekë të njëjtën skemë edhe në atë të Frontit Antifashist dhe të Frontit Nacionalçlirimtar, i cili do të bjerë kryesisht në duar të komunistëve shqiptarë, të mbikëqyrtur nga ata jugosllavë. Kjo për pasojë do të ketë, krahas heqjen dorë nga organizimi partiak mbi bazat e realiteteve shtetërore, edhe moslejimin e konsolidimit të frontit antifashist shqiptar në lëvizje demokratike nacionalçlirimtare me spektër të gjerë anëtarësimi, ku do të kishte vend edhe për forcat e tjera kombëtare të interesuara që të përfshihen në lëvizjen antifashiste.

Kjo ishte pritur. Sepse nën direktivat e Milladinit dhe Dushanit, të cilët drejtpërdrejt ndikuan në themelimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë, në nëntor 1941 në

<sup>1734</sup> Dedije, Vladimir: “Jugoslovenski-albanski odnosi 1939-1948”, Beograd 1949, faqe 18-21.

<sup>1735</sup> Shih Rajeviq, Radoshin: “Autonomia e Kosovës”, Prishtinë 1987, faqe 347-351.

Tiranë, me ç'rast pos rendit të ditës, programit dhe statutit, ku fjalën do ta mbajë një Shqiptar nga Kosova i sjellë nergut si mbajtës i procesverbalit dhe diç më shumë,<sup>1736</sup> ata do të bëjnë që kahja e zhvillimit të lëvizjes komuniste në Shqipëri të jetë “syçelë” ndaj çfarëdo platforme kombëtare që do të mund t'i vishej Frontit Antifashist dhe Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Instruktorët jugosllavë në radhët e komunistëve shqiptarë me kohë të kthyer në urdhërdhënës, me vëmendje të madhe do të përgjojnë se mos komunistët shqiptarë do të ndikohen nga anash me ide kombëtare, në mënyrë që ato të parandaloheshin që në nismë. Kështu, do të ndodhë, që edhe intelektualët e majtë, që do t'i afrohen lëvizjes nga bindja se ashtu mund të krijoheshin rrethanat që të ruhet bashkimi kombëtar do të eliminohen, qoftë me intriga të brendshme që do të kurdisen prej tyre, qoftë me eliminimin e tyre me metodat e denoncimit “të tërthortë” tek organet policore shqiptare “me akuzën e sajuar” si veprimtarë komunistë, e cila ishte shumë e rrezikshme!<sup>1737</sup>

Janë të njohura shumë raste eliminimi të intelektualëve të njohur nga radhët e lëvizjes antifashiste me anën denoncimeve, siç do të ndodhë me likuidimin e Emin Durakut, më 28.XI.1942. Emin Duraku ishte njëri nga intelektualët nga Kosova, ndër më të dalluarit dhe politikisht më të përgatiturit për sfidat e prapaskenave me Sllavët, i cili do të denoncohet nga komunistët serbë tek xhandarmëria shqiptare si “agjent komunist jugosllav”.<sup>1738</sup> Kjo ndodhi pasi përfundoi Konferenca e Vitomiricës, ku për herë të parë merrnin pjesë komunistët shqiptarë nga Kosova, të cilët me direktivën e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë duhej të inkorporoheshin në strukturën partiake të Komitetit Krahinor të Partisë Komuniste të Jugosllavisë për Kosovën dhe Metohinë dhe aty ta thoshin fjalën e tyre.

---

<sup>1736</sup> Fjala është për Elhami Nimanin, aktivist komunist nga Prizreni. Elhami Nimani, vëlla i Xhavit Nimanit, i cili ishte anëtar i grupit të komunistëve të Korçës. Xh. Nimani, nga viti 1941, me urdhrin e partisë komuniste shqiptare, bashkë me disa të tjerë, kthehet në Kosovë, të ndihmojë masivizimin e Luftës Nacionalçlirimtare ndër shqiptarë nën mbikëqyrjen e komunistëve jugosllavë. Xh. Nimani ishte edhe pjesëmarrës i Konferencës së Bujanit dhe nënshkrues i Rezolutës së saj. Më gjerësisht shih Mugosha, Dushan: “*Shënime nga puna në Shqipëri*” 1941 -1945.

<sup>1737</sup> Më gjerësisht rreth direktivave jugosllave që të pengohet infiltrimi i “trockistëve” dhe nacionalistëve në radhët e komunistëve shqiptarë shih Dedijer, Vladimir: *Jugoslovenski-albanski odnosi 1939-1948*, Beograd 1949, faqe 32-33; Dizdarević, R: “*Albanski dnevnik*”.

<sup>1738</sup> Familja e Emin Durakut në Gjakovë ka të dhëna me shkrim nga hetuesia e xhandarmerisë në Prizren se Emini ishte rrethuar në saje të një denoncimi që i kishte ardhur policisë nga një informant se në afërsi të Lipjanit gjendeshin disa agjentë serbë, që po përgatishnin një aksion lufte ndaj xhandarmerisë shqiptare. Pasi që xhandarmeria kishte rrethuar vendin dhe kishte bërë thirrje për dorëzim, nga ana e kundërt kishte pasur të shtëna drejt tyre. Aty ishte gjetur i plagosur jo një serb, siç informohej, por Emin Duraku, i paarmatosur fare, i cili do të dërgohet në spitalin e Prizrenit ku edhe do të vdesë. Më vonë do të merret vesh se pritis i kishin ikur në rrethana të dyshimta ata që e përcillnin Emin Durakun, njëri prej tyre ishte M. Milkoviq, funksionar i lartë partiak.

Në Konferencën e Vitomiricës, Emin Duraku kishte dalë me tezën e njohur se Lufta Antifashiste në Kosovë duhet të bëhet në përputhje me interesat e popullit Shqiptar të Kosovës dhe të zgjidhjes së drejtë të çështjes kombëtare.<sup>1739</sup>

Qëndrimi i E. Durakut ndezi polemikat midis komunistëve shqiptarë dhe atyre serbë, ku u pasqyruan pikëpamje të kundërta rreth çështjes së Kosovës me ç'rast, nga ana e shqiptarëve u theksua se e ardhmja e saj duhet të përcaktohet në përputhje me vullnetin e popullit të saj. I dërguari special i Titos për Kosovën dhe Maqedoninë do ta njoftojë i alarmuar Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë rreth "rrymave të dyshimta irredentiste midis komunistëve shqiptarë", të cilët, "të ndikuar nga idetë shqiptaro-mëdha nga Shqipëria" kanë për qëllim që këtë frymë "ta infiltrojnë" edhe në udhëheqjen komuniste në Kosovë "ndaj të cilës duhet pasur kujdes që të luftohet me kohë".<sup>1740</sup>

Edhe çështja tjetër, ajo që ka të bëjë me përfshirjen e Kosovës në Lëvizjen Antifashiste në kuadër të strukturës organizative të Luftës Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë, që udhëhiqej nga komunistët jugosllavë, ndikoi drejtpërdrejt në zhvillimin e Lëvizje Antifashiste në Kosovë si dhe në drejtimin e saj të përgjithshëm që të marrë kahun ideologjik, duke u zhveshur pak nga pak, por me perfiditet nga çdo segment që do të mund të shfrytëzohej më vonë si alibi për të drejtën e Kosovës që të deklarohet në përputhje me vullnetin e popullit të vet, që ia garantonte pjesëmarrja në luftën antifashiste në përputhje me Kartën e Atlantikut.

Edhe këtu, komunistët jugosllavë të ndihmuar nga ata shqiptarë, do të luajnë lojërat e tyre perfide, që do të dalin në pah në prag të mbarimit të luftës dhe veçmas pas saj, kur Kosova sërish dhe dhunshëm do të mbetet nën pushtimin jugosllav, nën tutelën e Serbisë "demokratike" si "oblast" (provincë) e saj, pasi që të ketë kaluar nëpër regjimin e vendosjes së gjendjes ushtarake dhe të shuarjes me gjak të rezistencës patriotike kundër pushtimit komunist të Kosovës, e cila shpërtheu në të gjitha pjesë e Kosovës nga vjeshta e vitit 1944 për të vazhduar me një

---

<sup>1739</sup> Në bisedën e autorit me Fadil Hoxhën, në tetor 1994 në Prishtinë ai pranoi faktin shpesh të kamufluar se Emin Duraku në mbledhjen e Vitomiricës, në afërsi të Pejës, kishte dalë me platformën e qartë për mbrojtjen e të drejtave të popullit shqiptar të Kosovës pas luftës, të cilat duhej të ishin në përputhje me interesat e tij, pra që të respektohej vullneti i tij me vetëvendosje. Aty do të ndodhë edhe një konfrontim midis qëndrimit të përfaqësuesve shqiptarë dhe atyre serbë dhe malazias, të cilët theksonin se ishte herët që të hapeshin çështjet e tilla, që duhej të zgjidheshin pas fitores ndaj fashizmit në "përputhje me qëndrimet internacionaliste". Emin Duraku theksonte se shqiptarë nuk mund të përfitoheshin në luftë vetëm me parulla të thata dhe pa garanci të qarta dhe të forta se në atë luftë do të fitonin të drejtat e tyre. Fadil Hoxha pranon se edhe vrasja e Emin Durakut ishte një komplot i organizuar, që ai të eliminohej, por pa denjuar që të emëronte fajtorët.

<sup>1740</sup> Shih: Letra e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë drejtuar Komitetit Krahinor të Partisë Komuniste të Jugosllavisë për Kosovë dhe Metohi. Cituar sipas Spasoje Djaković: "*Sukobi na Kosovu*", Beograd, 1984, faqe 382-386.

kryengritje të përgjithshme gjatë pranverës dhe verës së vitit 1945 me një epilog tragjik në Drenicë, që do të vlerësohej si “kundërrevolucion shqiptar”.

Prapaskenat jugosllave kundër Kosovës filluan në dy drejtime: në atë të organizimit partiak, dhe në atë të organizimit të Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar të drejtuar nga komunistët, prej nga pak nga pak do të përjashtohen që të gjitha forcat patriotike dhe ato nacionaliste në mënyrë që një ditë mbi këto baza të bëhet qërimi i hesapeve me të djathtën shqiptare.

Organizimi partiak, në të vërtetë, as që ka pasur ndonjë mundësi të lirohet nga mbërthimi i koncepteve ideologjike dhe klasore në rrethanat kur atij i ishin përcaktuar kornizat jugosllave. Por, meqë këto ishin pranuar dhe, Partia Komuniste e Shqipërisë do të shfaqet madje në rolin e agjitpropit të përhapjes së frymës komuniste edhe në Kosovë dhe të marrjes përsipër të masivizimit të saj me parullat e njohura internacionaliste *“të zgjidhjes së të gjitha çështjeve kontestuese dhe problemeve të trashëguara nga e kaluara, në përputhje me të drejtën e popujve për vetëvendosje, por që për këtë të bisedohej dhe të vendosej pasi që të fitohet lufta”*, ishte e pritshme që intelektualët majtistë me prejardhje nga Kosova të përfshihejshin në këtë veprimtari. Kështu, Fadil Hoxhës, Hajdar Dushit, Emin Durakut, SabrijeVokshit (Bija), Xhevdet Dodës, Xhavid Nimanit, Xheladin Hanës, Ismet Shaqirit, HysniZajmit, Meriman Brahës, Elhami Nimanit, Xhevdet Hamzës, MazllomKëpuskës, Hajdar Dushit dhe të tjerëve kosovarë që ndiqnin shkollimin në Shqipëri dhe atje u kishin takuar grupeve komuniste të Korçës ose të Shkodrës, iu desh që “me detyra partiake” të ktheheshin në Kosovë. Në Kosovë duhej të inkorporoheshin në bazën partiake të dominuar nga Serbët dhe Malaziasit dhe në Frontin Nacionalçlirimtar, që mezi hetohej. Por, edhe në ato rrethana tepër të vështira, ia dolën që të krijojnë aradhet e vogla partizane. Fillimisht atë “Zejnel Hajdini”, ndërsa më vonë aradhen “EminDuraku”, “Aradhen e Sharit”, të Shalës dhe më vonë edhe batalionin “Bajram Curri”, i cili operoi në zonën e Dukagjinit dhe të Tropojës.<sup>1741</sup>

Këto njësite partizane, edhe pse të vogla dhe me rreze veprimi tepër të ngushtë, megjithatë patën rëndësi, meqë pasqyrojnë edhe atë pjesë të përcaktimit shqiptar që të luftohet fashizmi si ideologji, por jo edhe realitetet e reja që ua kishte sjellë Shqiptarëve.

---

<sup>1741</sup> Më gjerësisht rreth formimit të aradheve partizane në Kosovë shih Dr. Ali Hadri: *“Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë”*, Prishtinë, 1971; Fadil Hoxha: *“Kur pranvera vonohet”*, Prishtinë; *“Një jetë në shërbim të atdheut”*, Prishtinë, 2007, Spasoje Djaković: *“Sukobi na Kosovu”*, 1984.

Këtu zë fill edhe ajo nyja e dilemës shqiptare që ka të bëjë me qëndrimin ndaj fashizmit në përgjithësi, që, në një rën anë t’i pranohen meritat dhe frytet (bashkimi kombëtar ndonëse jo i plotë, por edhe si i tillë mjaftonte që atë ta kthente si çështje që duhej dhënë një përgjigje), ndërsa në anën tjetër, të luftohej si pushtues por edhe si ideologji. Kjo dilemë, me kohë sa vinte dhe fitonte në peshë, kur bëhej gjithnjë e më e qartë se fashizmi, pasi që në luftë kundër tij ishin hyrë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në aleancën e lidhur antifashiste kishin përfshirë edhe Bashkimin Sovjetik dhe fuqitë tjera botërore, nuk e kishte të gjatë më të drejtë haptë çështjen se çfarë do të ndodhte pas largimit të fashizmit, kur ishte më se e qartë se pushtuesit e deridjeshëm sërish do të ktheheshin, ndonëse me një petk të ri, siç ishte ai i vëllazërim-bashkimit, që premtonte barazi dhe zgjidhje të problemeve të së kaluarës me receta ideologjike, të cilave nuk mund t’u besohej fare. Sepse, serbët edhe me rastin e depërtimit të parë në hapësirën Shqiptare në vitin 1877/8, edhe në prag të luftërave ballkanike, Shqiptarëve u kishin premtuar “se pas çlirimit nga osmanët” do të ketë paqe dhe barazi dhe jetë të përbashkët, por kishin bërë të kundërtën. Kujtimet nga luftërat e fundit ishin ende të freskëta, siç ishin të njoma edhe pellgjet e gjakut dhe tragjedia nëpër të cilën ishte kaluar gjatë tri dekadave të fundit.

Meqë realitetet ishin të tilla, që fashizmi nuk kundërshtohej nga populli i Kosovës, ndërsa ardhja e Gjermanëve si dhe sjellja e tyre do të heqë edhe ato pak dyshime që kishin lënë Italianët me rrënimin e Mbretërisë Shqiptare dhe bashkimin e Shqipërisë me mbretërinë e derës së Savojës me Viktor Emanuelin III, jugosllavët perfidë që drejtonin komunistët shqiptarë në Shqipëri, në Kosovë do të tregojnë durim, duke mos u ekspozuar, në pritje të dobësimit të fuqisë së Gjermanëve në Lindje, e cila pashmangshëm se pasqyrohej edhe me gjendjen e tyre në Ballkan, ku shumë njësi të tyre tërhiqeshin në drejtim të Veriut, për të krijuar frontin e ri europian të mbrojtjes tek Elba, kundër depërtimeve të Ushtrisë së Kuqe sovjetike dhe në Normandi, kundër zbarkimit të paralajmëruar anglo-amerikan.

Pas kapitullimit të Italisë, në vjeshtën e vitit 1943, komunistët jugosllavë filluan të tregojnë gjithnjë e më shumë interesim për zhvillimin e luftës antifashiste në Kosovës me përkushtimin që atë ta mbajnë të lidhur për vete. Ndonëse pa kurrfarë kontaktesh “me bazën partiake”, që e mbanin në defterët e tyre si të themeluar që nga vitit 1939, (pos ndonjë emisari që hynte tebdil në rrugë për në Shqipëri), të dërguarit jugosllavë të Enveri, Milladini dhe Mugosha, do të kërkojnë bashkëpunim midis aradheve partizane të Kosovës dhe të atyre të Shqipë-

risë. Këtë madje e kërkonin edhe në emër të partizanëve kosovarë, me të cilët ata po ashtu nuk kishin as lidhje fizike. Megjithatë ata ruanin “të drejtën” të flisnin në emër të tyre në saje të qëndrimit të komunistëve jugosllavë me çka do të pajtohen edhe komunistët shqiptarë, që organizimi partiak dhe ai i frontit antifashist në Kosovë të mbetej “në kompetencë” të komunistëve jugosllavë.

Gjatë katër viteve të këtij paralelizmi në Kosovë, i ngarkuari i posaçëm i Titos për Kosovën dhe Maqedoninë, Svetozar Vukmanović - Tempo, vetëm një herë, nga fillimet e vitit 1943, tebdil, për dy ditë, në rrugë për në Tiranë, do të ketë qëndruar në Kosovë (i strehuar në Prizren në familjen Nimani).<sup>1742</sup> Tebdil dhe të masakuar me emra shqip kishin qenë edhe ata pesë-gjashtë serbë, të cilët kishin marrë pjesë në aradhet partizane të Kosovës, ndër ta Pavle Jovičevići (Paloka), Millan Mičković (Shefqeti), Dragutin Gjorgjević (Dauti), Milan Zečari (Zeça) dhe ndonjë tjetër, maskim ky që do të jetë fatal për Shqiptarët. Sepse, nga mbarimi i luftës, pas vendosjes së administratës ushtarake në Kosovë, më 8 shkurt të vitit 1945, ata do të jenë arbitrit kryesorë që do të përcaktojnë “miqtë” e paktë shqiptarë nga radhët e Nacionalçlirimtares (por gjithnjë të dyshuar) dhe “armiqtë” e shumtë shqiptarë, që për ta ishin ballistët, ishin intelektualët, ishin patriotët dhe ishin që të gjithë ata që kishin mbrojtur idenë e bashkimit Shqiptar, me të cilët do të qërohen hesapet në mënyrën më të egër dhe në mënyrën më të përgjakshme nën anatemën e “armiqve të popullit” dhe “të bashkëpunëtorëve të okupatorit fashist”.

Para se të ndodhte ky kalavar gjaku, që është anashkaluar ose fshehur nga historiografia ideologjike shqiptare dhe ajo jugosllave, komunistët shqiptarë nga Kosova të shkolluar në Shqipëri si dhe intelektualët e tjerë që ishin përfshirë në Lëvizjen Nacionalçlirimtare, si të dërguar nga Partia Komuniste e Shqipërisë, ose që me vetiniciativë ishin angazhuar t’i ndihmohet çështjes së bashkimit kombëtar, dhe me kohë kishin arritur të merrnin ca poste drejtuese në radhët e strukturës komanduese të luftës po edhe nëpër Këshillat Nacionalçlirimtare, të cilat paraqitnin bërthamat e pushtetit vendor, do të veprojnë drejt mëvetësisimit të strukturës organizative të luftës dhe të atyre të “pushtetit popullor”, pa marrë parasysh se këto struktura ishin thuajse të pavërejtura dhe, në raport me strukturat e pushtetit vendor dhe të administratës që ushtrohej në gjithë vendin nga autoritetet

---

<sup>1742</sup> Shih: Svetozar Vukmanović – Tempo: “Memoari”, I, II, 1985.



shtetërore, i cili gëzonte përkrahjen e të gjithë Shqiptarëve, jashtë ndonjë ndikimi në jetën e përditshme.

## PËRÇARJET SHQIPTARE MBI PËRKATËSITË IDEOLOGJIKE DHE DIKTATI JUGOSLLAV

Hapja e gamës së rivalitetit politik në Shqipëri me pjesëmarrjen e të djathtës shqiptare, krijoi mundësi që fronti antifashist të zgjerojë spektrin mbi baza të gjëra demokratike. Kjo Shqipërisë ia ofronte mundësitë që e ardhmja e saj të mos përcaktohej mbi aspektet ideologjike, por ato demokratike.

Këtij qëllimi do të duhej t'i shërbente prania e misionit britanik në Shqipëri<sup>1743</sup> dhe e misionarëve të tjerë nga fuqitë aleate nga fillimi i vitit 1943 e deri në prag të mbarimit të luftës.

Kjo prani, si do të shihet, nuk kaloi pa vështirësi dhe madje mund të thuhet se nuk ia doli të përmbush qëllimin e parë, pra krijimin e rrethanave që në Shqipëri të pengohej fitorja e të majtëve, që për parakusht kishte që faktori politik shqiptar të lidhej rreth një platforme të përbashkët nacionale properëndimore. Ky dështim pati për shkak involvimin e faktorit jugosllav, atij politik dhe ushtarak, gjatë gjithë kohës, që Frontin Antifashist shqiptar ta futë nën ombrellën e komunistëve shqiptarë të dirigjuar nga komunistët jugosllavë.

Pa marrë parasysh këtë epilog, që ndikoi që Shqipëria dhe Shqiptarët të mbehen në botën lindore, pra peng i komunizmit, mund të thuhet se Britania e Madhe ishte vendi i parë nga Fuqitë e Mëdha, e cila shfaqti interesimet për zhvillimet në Shqipëri nga pushtimi fashist e deri te fundi i luftës. Diplomacia dhe shërbimet ushtarake britanike u lidhën me disa nga nacionalistët shqiptarë (AbazKupin, vëllezërit Kryeziu nga Gjakova, Mustafa Gjinishin e të tjerë). Prej tyre kërkohesh përfshirja në kuadër të frontit antifashist edhe përkundër rrethanave specifike nëpër të cilat kalonte bota shqiptare, veçmas pas bashkimit të trojeve shqiptare që u bënë nga Italia dhe Gjermania nga viti 1941 e këndej. Pas dy vjetësh, më 1943, Britania e Madhe dërgoi në Shqipëri misionin e parë ushtarak të kryesuar nga majori Bill Maklin, që

---

<sup>1743</sup> Rreth misionit britanik në Shqipëri shih: Hibert: *"Fitorja e hidhur"*, Tiranë, 1993; Tilman, William, Amerym Julian dhe Kemp, Peter: *"Kujtime që nuk shlyhen"*, Tiranë 1984 dhe Smiley: *"Albanian Assignment"*, 1984; Gjenerali Davies: *"Aventura ilire"*, Tiranë.

hyri nga Greqia. Misioni britanik u mirëprit ngas Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH dhe iu krijuan mundësi të vende lidhje me forcat e ndryshme antifashiste.<sup>1744</sup>

Akomodimi i suksesshëm i majorit Maklin ndër Shqiptarët si dhe spektri i gjerë i informatave që siguronte, bëri që britanikët të nisin për në Shqipëri një mision të nivelit të lartë, të kryesuar nga gjeneral brigade, Edmond Dejvis, së bashku me një shtab të madh, me kolonelin A. Nikas, si shef të shtabit. Misioni “Dejvis” nga SOE (Drejtoria e Operacioneve Speciale) vuri bazat e misioneve të tjera, siç ishte ai i përbërë nga majori Riçard Ridëll dhe kapiteni Antoni Simkoks, që do të vendosen në zonën e Dibrës.<sup>1745</sup>

Gjenerali Dejvis, sapo erdhi u takua me E. Hoxhën, nga i cili kërkoi që të ndaleshin sulmet kundër “Ballit Kombëtar”, edhe përkundër rezervave që Britanikët kishin ndaj kursit “të rezervuar” të nacionalistëve shqiptarë ndaj gjermanëve.<sup>1746</sup>

Në nëntor të vitit 1943, gjenerali Dejvis u takua me udhëheqësit e “Ballit Kombëtar”, me të cilin u arrit një marrëveshje që ata t’i sulmonin forcat gjermane, por siç merret vesh, Mid’hat Frashëri angazhimin e plotë të ballistëve në veprimet luftarake kundër Gjermanëve e kushtëzoi me ndaljen e veprimeve luftarake të partizanëve shqiptarë kundër forcave të Ballit, të cilat, sipas Frashërit bëheshin nën direktivat e Jugosllavëve që të dështojë çfarëdo bashkëpunimi midis forcave nacionaliste dhe të majtëve, në mënyrë që drejtimi i Luftës Antifashiste në Shqipëri t’u mbetet i tëri partizanëve, të cilët ruanin kursin e Beogradit.<sup>1747</sup>

Pas këtyre bisedimeve dhe vëzhgimeve në vend, gjenerali Dejvis dërgoi në Londër raportin e parë, me ç’rast ai sugjeronte mbështetjen e të gjitha forcave politike në Shqipëri, pavarësisht nga orientimi i tyre ideologjik, pa ndërhyrë në luftën civile që zhvillohej.<sup>1748</sup>

Ky hap u mundësua pasi që në dhjetor të vitit 1942, ministrat e jashtëm të tri Fuqive Aleate (SHBA-ve C Hull, Britanisë së Madhe – Iden dhe të Bashkimit Sovjetik – Molotov) shpallën qëndrimin e qeverive të tyre ndaj zhvillimeve në Shqipëri, me ç’rast në deklaratën e përbashkët që të tre ministrat çmonin ndihmësën që deri atëherë kishte dhënë populli shqiptar në luftë kundër pushtuesit fa-

---

<sup>1744</sup> Shih “*Historia e popullit shqiptar*”, vëll. IV, Tiranë 2008, faqe 106; Smiley: “*Albanian Assignment*”, 1984, faqe 49, 118.

<sup>1745</sup> Gjenerali Davies: “*Aventura ilire*”, Tiranë, f. 57; 108; Smiley: “*Albanian Assignment*”, 1984, f. 49, 118.

<sup>1746</sup> Po aty, faqe 58-59.

<sup>1747</sup> Shih: Këlcyra, Ali: “*Shkrime për historinë e Shqipërisë*”, Tiranë 2008, faqe 192.

<sup>1748</sup> Smiley: “*Albanian Assignment*”, 1984, faqe 118.

shist italian dhe ripohonin pavarësinë kombëtare që Shqipëria gëzonte para se të pushtohej nga fashistët italianë në vitin 1939.<sup>1749</sup>

Në një raport tjetër të mëvonshëm, gjenerali Dejvis, pasi që bën të ditur se gjendja në vend kishte ndryshuar, kërkon denoncimin e “Ballit Kombëtar” dhe të Zogistëve, meqë, sipas tij, ata bashkëpunonin hapur me Gjermanët.<sup>1750</sup>

Sugjerimet e Dejvisit nuk u përfillën gjithaq nga Forin Ofisi, ngaqë gjenerali Maklin, i cili mbante lidhje të mira me Ballin dhe Kupin, vlerësonte se Fronti Nacionalçlirimtar nuk duhej të mbetej i tëri në duar të partizanëve shqiptarë, që drejtoheshin nga Jugosllavët, ngaqë kjo rrëronte baraspeshën e interesave britanike në këtë pjesë. Madje, me sugjerimet e gjeneralit Maklin, Britanikët forcuan kontaktet me nacionalistët shqiptarë në veri, duke dërguar atje në mision të veçantë Smilej, Maklin dhe të tjerë, të cilët, bënë çmos që nacionalistët shqiptarë (Balli Kombëtar) të mos përfshiheshin në luftë në krahun e Gjermanëve, mision ky që si dihet mbeti pa ndonjë sukses.<sup>1751</sup>

Në pranverën e vitit 1944 misioneve ushtarake britanike u shtohen edhe misioni ushtarak amerikan, i drejtuar nga kapiteni Tomas Stefani si dhe misioni sovjetik, i kryesuar nga majori Ivanov.<sup>1752</sup>

Edhe pse mund të thuhet se misionarët e Fuqive të Mëdha në Shqipëri ishin me detyra të përcaktuara nga shtabet e tyre, ku në plan të parë ishin ato të natyrës gjeostrategjike, të cilave në Shqipëri gjeopolitika ua përcaktoi epilogun, duke mbetur në sferën lindore, pra sovjetike, mund të thuhet se e dhathta shqiptare, e këshilluar nga Anglo-Amerikanët, u detyrua që në nivel të vendit, të hyjë në bisedime me komunistët, që të krijohej një front demokratik antifashist në Shqipëri, ku do të kishte vend për të gjithë. Komunistët, të cilët edhe më parë kishin dhënë shenja se ishin për një luftë të përbashkët, por me synimin që atë ta drejtonin, siç do të ndodhë në të vërtetë, e pranuan këtë sfidë nga frika se mund të marginalizoheshin dhe të anatemoheshin thjeshtë si pro-sovjetikë, gjë që do t'i dëmtonte me të madhe.

Pas disa takimeve midis forcave të ndryshme politike, ku nacionalistët shfaqeshin më të vullnetshëm për marrëveshje të përgjithshme, ku tashmë Balli Kombëtar, kishte filluar t’ia krijonte kornizat në përputhje me parimet e “Dekalogut”, mbledhja e parë e përfaqësuesve të të dy palëve u bë në Tapizë afër Tiranës, më 26 korrik 1943, një takim ky përgatitor për Konferencën e përgjithshme.

---

<sup>1749</sup> “*Historia e popullit shqiptar*”, vëll.IV, Tiranë 2008, faqe 61.

<sup>1750</sup> Po aty. Faqe 108.

<sup>1751</sup> Shih: Smilej: “*Albanian Assignement*”, 1984; Hiber: “*Fitorja e hidhur*”, Tiranë 1993.

<sup>1752</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëll. IV, Tiranë 2008, faqe 109.

Po këtë ditë në Shkodër, nga Balli u organizuan demonstratat e mëdha kundër pushtuesit italian, në të cilat morën pjesë rinia e qytetit dhe shumë intelektualë të njohur. Në këto demonstrata u vra profesori i gjimnazit Mustafë Dërvishi, kretar i rinisë së Ballit. Ato patën për shkas rënien e Musolinit, me çka Shqipërisë i jepej një shenjë e mirë se pushtuesi italian ndodhej para rënies.<sup>1753</sup>

Në atmosferën e kësaj demonstrate dhe dobësimit të fashizmit italian, mbledhja përgatitore duhej të kthehej në një demonstrim të bashkimit shqiptar në mënyrë që t'u bëhej ballë sfidave që ishin në prag dhe kishin rëndësi për të ardhmen e vendit. Kjo bëri që pjesëmarrja e delegacioneve të ishte në nivelin më të lartë, siç ishte ai i Delegacionit të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar i përbërë prej major Abaz Kupit, Myslim Pezës, Ymer Dishnicës dhe Mustafa Gjinishit; i organizatës “Balli Kombëtar” i përbërë prej Mit’hat Frashërit, Hasan Dostit dhe Faik Qukut, me ç’rast M. Frashëri u zgjodh kryetar i mbledhjes dhe Mustafa Gjinishi sekretar.<sup>1754</sup>

Në takimin e Tapizës u rrahën dy çështje kryesore: si do të organizohej më mirë e në stil më të gjerë lufta e armatosur kundër okupatorit si dhe *problemi i Shqipërisë etnike*, veçanërisht ai i Kosovës, për të cilin u arrit një konkluzion se do të kërkohet zgjidhja në përputhje me Kartën e Atlantikut.<sup>1755</sup>

Protokolli i mbledhjes së Tapizës u firmos nga Ymer Dishnica, Abaz Kupi, Mustafa Gjinnisi dhe Myslim Peza, që kishin mandatin e plotë të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar. Në këtë mbledhje, po ashtu, u kërkua që në takimin e ardhshëm përfundimtar, të shpallej pavarësia e Shqipërisë, ku u bë fjalë edhe për formimin e një qeverie provizore në Krujë.<sup>1756</sup>

Ndërsa mbledhja e dytë, ku u arrit marrëveshja, u mbajt më 1-2 gusht në Mukje të Krujës. Nga Këshilli i Përgjithshëm i Frontit Nacionalçlirimtar morën pjesë Ymer Dishnica, Mustafa Gjinishi dhe Abaz Kupi, të cilët nënshkruan marrëveshjen e përbashkët, sipas të cilës u pranua propozimi i “Ballit Kombëtar” për krijimin e “Komi-

<sup>1753</sup> Butka, Uran: “Mukja – shans i bashkimit, peng i tradhtisë”, Tiranë 2007, faqe 39.

<sup>1754</sup> Po aty.

<sup>1755</sup> “Karta e Atlantikut”, dokumenti më i rëndësishëm ndërkombëtar i firmosur më 14 gusht 1941 nga Ruzvelt dhe Çerçilli, lajmëronte fillimin e një epoke të re në marrëdhëniet midis kombeve dhe kombësive mundësonte vetëvendosjen dhe shënonte një hap të rëndësishëm për zgjerimin e aleancës kundër fashizmit. Kjo kartë kishte mbështetje ndërkombëtare për zgjidhjen e drejtë edhe të çështjes kombëtare shqiptare si dhe të pjesëmarrjes shqiptare në koalicionin antifashist.

<sup>1756</sup> Propozimi për formimin e qeverisë provizore në Krujë doli nga major Abaz Kupi dhe u përkrah nga M. Frashëri dhe të tjerët, por u hoq nga rendi i ditës me insistimin e Mustafa Gjinishit, i cili tha se kjo nuk do të pranohej nga Nacionalçlirimtarja, ngaqë Kruja lidhej me A. Kupin, si vendlindje e tij. Kjo shtyri Y. Dishnicën që, po qe se merret ky vendim të cilin ai do ta përkrahte, të propozojë Vlorën me çka ndërliedhej me atë të aktit të pavarësisë kombëtare të vitit 1912. Si dihet, kjo pikë do të hiqet nga rendi i mbledhjes së Mukjes me insistimin e komunistëve, të cilët paraprakisht duhej të mermin pëlqimin e jugosllavëve, të cilët në parim ishin kundër çfarëdo qëndrimi të kësaj natyre para se të arrihej fitorja kundër nazi-fashistëve. (Shih: Butka, Uran: “Mukja...”, fq. 43).

*tetit për Shpëtimin e Shqipërisë*". Ky komitet do të përbëhej nga 6 përfaqësues të Organizatës "Balli Kombëtar" dhe 6 përfaqësues të Frontit Nacionalçlirimtar. Ky komitet do të binte me formimin e një qeverie provizore. Komiteti provizor, krahas detyrave të tjera, kishte edhe atë të shpalljes së indipendencës (pavarësisë).

Në marrëveshje po ashtu parashihej që lufta e përbashkët të kishte për qëllim mbrojtjen etnike të shtetit shqiptar. Kjo çështje u sanksionua me Pikën 2 të marrëveshjes së Mukjes, e cila, siç pritej, ishte "më e nxehta" dhe më e përfolura pastaj, ku do të thyhen "shpatat" nga të dy anët, ngaqë aty bëhej fjalë për bashkimin shqiptar në baza etnike, ku përfshiheshin Kosova dhe pjesët e tjera që i ishin bashkuar Shqipërisë, po ku duhej të përfshiheshin edhe ato pjesë që u ishin lënë Bullgarëve dhe Mitrovica me rrethinë që mbaheshin nga Gjermanët. Po ashtu, aty theksohej rëndësia e Ulqinit, Tivarit dhe pjesëve të tjera, që duhej t'i takonin Shqipërisë.<sup>1757</sup>

Karshi kësaj çështje madhore, shihej se "Ballistët" ishin më të qartë, më të përcaktuar dhe më të vendosur, pra që kishin një platformë mbi të cilën kërkonin që të luftohet për shtetin etnik shqiptar, ndërsa komunistët kishin preokupim *shtetin shqiptar*, pra pa fjalët *luftë* dhe *etnik*. Gjinishi kërkonte që çështja e Kosovës të mos ngarkojë marrëveshjen, meqë përqendrimi duhej të bëhej tek kufijtë e pranuar ndërkombëtarisht dhe arsyetime të ngjashme. Madje, ai deklaronte "se e rëndësishme ishte një marrëveshje që ruan Shqipërinë dhe jo që e dëmton", duke aluduar te "krijesat e fashizmit", me të cilat komunistët nuk duhej të pajtoheshin.<sup>1758</sup>

Përfaqësuesit e Ballit, në krye me Mid'had Frashërin, vlerësonin se bashkimin shqiptar nuk e kishte bërë as fashizmi e as të tjerët, por e drejta e popullit shqiptar që të jetojë i bashkuar, e cila ishte nëpërkëmbur në Londër dhe Paris. Ata mbronin qëndrimin se "*nëse fashistët kanë bërë diçka të mirë dhe në interesin e Shqiptarëve, askush nuk ka të drejtë të heqë dorë nga kjo e mirë, po të përpiqet që atë ta krijojë në fakt të kryer.*"<sup>1759</sup>

Pra, M. Frashëri e shikonte zgjidhjen e çështjes së Kosovës të pandarë me atë të luftës për çlirim kombëtar", sepse çdo formë çlirimi që të mos jetë kurorëzuar me bashkim me mëmëdheun, asht pa dyshim një zgjedhë e dytë".<sup>1760</sup>

Duke polemizuar me disa nga përfaqësuesit e Nacionalçlirimtares (Gogo Nushine Myslim Pezën, pse i pari kishte thënë "ç"na duhet Kosova, ne kemi hallin e

<sup>1757</sup> Po aty.

<sup>1758</sup> Më gjerësisht rreth Mukjes dhe atyre që do të pasojnë shih librin Uran Butka: "*Mukja – shans i bashkimit, peng i tradhtisë*", Tiranë, 1998.

<sup>1759</sup> Po aty, faqe 54.

<sup>1760</sup> Shih te AQSH, faqe 14 - Trakti i Ballit Kombëtar, korrik 1943

Shqipërisë” dhe i dyti se “Kosovën na e ka falë fashizmi!” dhe “ne nuk pranojmë dhurata nga fashizmi”), M. Frashëri ishte përgjigjur se nacionalistët shqiptarë kur bisedojnë për Kosovën dhe vise tjera të shkëputura nga pushtuesit serbë e grekë, mendojnë për Shqipërinë etnike, si një e drejtë etnike dhe historike që u takon Shqiptarëve, dhe se askush nuk ka të drejtë të heqë dorë prej saj, e aq më pak zgjidhjen e drejtë të saj ta shikojë çështje të jashtme ose “dhuratë të huaj”, ngaqë ajo është çështje shqiptare, që ka të bëjë me qenien tonë dhe të drejtën tonë të jetojmë të lirë dhe të bashkuar si popujt tjerë.<sup>1761</sup>

Pas shumë bisedash dhe kompromisesh, po edhe të gatishmërisë së Ymer Dishnicës, që udhëhiqte delegacionin e Frontit Nacionalçlirimtar, që kësaj çështje t’i jepej përgjigje historike pa çarë gjithaq kokën se ç`mendnin komunistët nga Beogradi deri në Moskë, do të pranohet formulimin në të cilin thuhet:

*“Do të luftohet për një Shqipëri indipendente dhe për zbatimin e parimit të njohur universalisht të garantuar nga karta e Atlantikut të vendosjes së popujve për një Shqipëri etnike”.*<sup>1762</sup>

Neni 2 i kësaj marrëveshje kërkonte respektimin dhe njohjen e vullnetit mbarëshqiptar për një Shqipëri etnike, të pavarur dhe demokratike. Nëpërmjet zbatimit në praktikë të këtij parimi mund të zgjidhej drejt çështja shqiptare si edhe të ndreqeshin padrejtësisë që i ishin bërë asaj gjatë shekujve.<sup>1763</sup>

Krahas pikës 2, që me formulimin: “Do të luftohet për një Shqipëri indipendente...”, i jepte përgjigje çështjes së Kosovës dhe të bashkimit shqiptar, edhe pika 3 e Marrëveshjes, në të cilën bëhej fjalë për sanksionimin “se forma e regjimit do të përcaktohej prej vetë popullit pas mbarimit të Luftës nëpërmjet të një Asambleje Kushtetuese, të zgjedhur me votim të përgjithshëm direkt”, u përcoll me shumë diskutime, ngaqë, si e tillë ajo gjendej në Dekalogun e “Ballit Kombëtar”. Por ajo u aprovua dhe me atë rast i viheshin bazat pluralizmit politik partiak me zgjedhje të lira, liri të mendimit, të besimit, shtypit e të fjalës, respektimit të iniciativës së lirë private dhe pronës, sigurimit të drejtave njerëzore e kombëtare.<sup>1764</sup>

Në ditën e tretë të punimeve të kuvendit, u mblodh Komiteti i Përkohshëm i Shpëtimit të Shqipërisë, i cili vendosi të dalë me një proklamata, në të cilën duhej të thuhej se lufta kundër pushtuesit do të bëhej nën moton “Ja vdekje, ja liri!”.

Në proklamata të drejtohej popullit shqiptar, pos të tjerash thuhej:

---

<sup>1761</sup> Butka, Uran: “Mukja...”, faqe 56.

<sup>1762</sup> Po aty, faqe 61.

<sup>1763</sup> Po aty, faqe 61.

<sup>1764</sup> Po aty.

“Po bëhen afër pesë vjet që Italia fashiste ka pushtuar vendin tonë të shtrenjtë dhe po e mbjell kudo zi e mjerim. Barbarizma ka arritur kulmin. Në këto kohët e fundit armiku ka ndjekë e ka shkatërruar fshatra e qytete dhe me një etje të tërbuar, ka vrarë e ka therur burra e gra... Po me gjithë vuajtjet dhe torturat e mëdha, armiku nuk mundi të shuajë në popullin tonë kreshnik flakën e shqiptarizmsë...”

Populli shqiptar, i cila ka ditur kurdoherë të bashkohet sa më ngushtë në raset e rrezikut të vendit të vet, dhe këtë radhë nuk mungoi të gjejë rrugën e drejtë, duke formuar një bllok të çeliktë dhe paraqitet sot me emrin “Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë” për bashkëpunim të të gjitha fuqive të organizuara të kombit, sipas marrëveshjes të plotë ndërmjet organizatës “Balli Kombëtar” dhe Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar.

Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë, shprehje e gjallë e fuqive të Kombit, paraqet këtë program:

*1. Luftë të përbashkët dhe të menjëhershme përbri Aleatëve të mëdhenj Anglisë, SHBA dhe Bashkimit Sovjetik si edhe të popujve të shtypur kundra pushtuesit barbar.*

*2. Luftë për një Shqipëri të Pavarme, luftë për zbatimin e parimit të njofun botërisht e të garantuar nga Karta e Atlantike të vetëvendosjes së popujve, për një Shqipëri etnike.*

*3. Luftë për një Shqipëri të lirë, demokratike e popullore.*

Komiteti për shpëtimin e Shqipërisë do të vazhdojë luftën tue udhëhequn popullin shqiptar në rrugën e sakrificës e të nderit deri në formimin e qeverisë provizore.

Forma e regjimit do të caktohet prej vetë popullit me anën e në Asambleje kushtetuese të zgjedhur me sufragh universal direkt.”<sup>1765</sup>

“Komiteti Provizor Për Shpëtimin e Shqipërisë” mori përgjegjësinë që ingarkonte Marrëveshja e Mukjes dhe vendosi që qysh të nesërmen e arritjes së saj ta përgëzonte vetveten si komitet drejtues i luftës së përbashkët me një betejë kundër pushtuesve italianë. Komandën, deri sa të krijohet shtabi i përbashkët, iangarkoi AbazKupit.<sup>1766</sup>

Deklarata e “Komitetit Provizor për Shpëtimin e Shqipërisë” bashkë me pajtimin rreth çështjeve madhore për të ardhmen e Shqiptarëve dhe të Shqipërisë që të jetojnë të lirë dhe të bashkuar në një shtet demokratik, si do të shihet, do të kthehet në mollë sherri. Ngaqë komunistët, nën ndikimin e Jugosllavëve, me të shpejtë do të heqin dorë nga marrëveshja e Mukjes. Kjo do t’ia hapë dyert jo vetëm përçarjes

<sup>1765</sup> Shih: AQSH, faqe 270, viti 1943, dosja 11.

<sup>1766</sup> Po aty.

së frontit antifashist por edhe luftës vëllavrasëse, që do të shpërthejë në Shqipëri dhe për pasojë do të ketë mbetjen e Shqipërisë në bllokun komunist.<sup>1767</sup>

Në të vërtetë, prishja e marrëveshjes së Mukjes nga ana e komunistëve shqiptarë, shikuar nga pasojat e rënda që pati, mund të konsiderohet si akt i madh itradhtisë kombëtare, që iu bë Shqipërisë dhe çështjes shqiptare në përgjithësi, ngaqë me anën e saj jugosllavët ia dolën që t'i pengojnë tri objektiva të mëdha shqiptare, që do të mund të arriheshin gjatë asaj kohe dhe në ato rrethana vendimtare:

a) bashkimin shqiptar në përputhje me Kartën e Atlantikut, si një e drejtë e patjetërsueshme;

b) bashkimin e forcave nacionaliste brenda një spektri të përbashkët demokratik si forcë kryesore e frontit antifashist shqiptar dhe

c) krijimin e rrethanave që Shqipëria t'i takojë botës së lirë dhe demokratike perëndimore.

Me pengimin e këtyre objektivave madhore për botën shqiptare, me prishjen e Mukjes në raport me Shqipërinë, jugosllavët, arritën tri qëllime strategjike, që ishin në përputhje me interesat antishqiptare të Beogradit të ndjekura që nga Kriza Lindore:

a) mbajtjen e Kosovës, Maqedonisë dhe të viseve të tjera shqiptare në Mal të Zi të pushtuara gjatë luftërave ballkanike dhe të ripushtuara pas Luftës së Parë Botërore në kufijtë e Jugosllavisë komuniste me ndihmën e madhe të politikës shqiptare;

b) sjelljen në pushtet në Shqipëri të komunistëve, vasalë të Titos dhe politikës së tij dhe

c) futjen e Shqipërisë komuniste në sferën lindore.

Nëse rreth çështjes së parë, asaj që kishte të bënte me bashkimin kombëtar, komunistët jugosllavë, të drejtuar nga Tito, do të tregohen paka më të përmbajtur, duke mos e mohuar këtë çështje, por që ajo të mbetej për më vonë dhe pasi që të fitohet lufta kundër fashizmit, demagogji kjo që do të përdoret me shumë e shumë dinakëri gjatë gjithë luftës, rreth çështjes së spektrit nacionalist në drejtimin e luftës si dhe pretendimit që Fronti Antifashist të udhëhiqej prej komunistëve, meqë ata këtë të drejtë e kishin fituar me luftën aktive kundër fashistëve, do të jenë të drejtpërdrejtë dhe të pakompromis madje.

Kjo do të shihet me reagimin e atypëratyshëm të M. Popoviqit, që sapo mori vendimet në dorë dhe i pa, i kishte grisur dhe gjithë zemërim ia kishte përplasur në fytyrë Enverit.<sup>1768</sup>

---

<sup>1767</sup> Po aty, faqe 54/55.

<sup>1768</sup> Butka, Uran: "Mukja...", Tiranë 2007, faqe 93.



Kështu, shqetësimi i madh jugosllav nga vendimet e Mukjes, që nuk i kishin pritur se do të jenë të asaj natyre, pra ku interesat kombëtare shqiptare do të gjejnë mbështete të përbashkët edhe nga përfaqësuesit e Nacionalçlirimtares mbi të cilët mendonin se kishin ndikim të plotë, bëri që me insistimin e emisarëve jugosllavë, të thirrej me nxitim në Vithkuq takimi me drejtuesit kryesorë të PKSHE të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Në këtë takim, me insistimin e Mugoshës dhe Popoviqit, Hoxhës iu urdhërua të prishë marrëveshjen, ndërsa nënshkruesve të saj (Ymer Dishnicës dhe Mustafa Gjinishit), edhe pse nuk ishin të pranishëm, iu bë gjuq, ku Mugosha hodhi poshtë Marrëveshjen e Mukjes dhe kërkoi dënimin kapital për Y. Dishnicën dhe M. Gjinishin. Ndërsa M. Popoviqi, duke kërkuar luftë të hapur dhe pa kompromis kundër nacionalizmit shqiptar, shkoi një hap më larg, pikërisht aty ku duhej,<sup>1769</sup> te pika që misionarët britanikë Hibert dhe Smajl e quajnë “strategji politike e PKSHE-së, që nacionalistët nga radhët e Lëvizjes Nacionalçlirimtare gjithsesi të shtyheshin që të dilnin njëllor bashkëpunëtorë të Italisë dhe të Gjermanisë”.<sup>1770</sup>

Në këtë drejtim E. Hoxha u tregua shumë i dëgjueshëm dhe ekspeditiv. Më 8 gusht 1943 lëshoi një qarkore partiake me anën e të cilës njoftonte bazën që të mos pranohet trakti që kishte shpallur Këshilli provizor i Shpëtimit të Shqipërisë në Mukje. Direktiva e tij ishte e qartë:

“Ky trakt është në kundërshtim me vijën nacionalçlirimtare dhe *disaprovohet* nga KQ i Partisë. Prandaj, në rast se nuk i keni shpërndarë, çirni dhe të mos flitet më për të”.<sup>1771</sup>

Se fjala ishte për një direktivë të jugosllavëve dhënë komunistëve shqiptarë në krye me E. Hoxhën, të cilën ata e kishin pranuar duke kërkuar falje, këtë e vërteton edhe letra që M. Popoviq dërguar Komitetit Qendror të PK të Jugosllavisë. Në të, pos tjerash thuhej:

“Kemi biseduar me KQ të PKSHE dhe studiuar çështjen, situatën atje dhe atëherë vendosëm që të nxjerrim një trakt që të mos njihet mënyra e organizimit të Komitetit për Shpëtim të Shqipërisë dhe as funksionimi i tij si instancë më e lartë e Nacionalçlirimtares”.<sup>1772</sup>

Ngjashëm bazës së vet partiake i drejtohet edhe Mugosha duke njoftuar se “Traktati i Konferencës së Mukjes shkaktoi një turbullirë të madhe. Organizata e Partisë në Vlorë, nën direktivën time, shkroi traktatin dhe ua drejtoi të gjitha një-

---

<sup>1769</sup> Po aty, faqe 94.

<sup>1770</sup> Shih: Hibbert: “Fitorja e hidhur”, Tiranë 1993; Smajl, D: “Me detyrë në Shqipëri”, Tiranë 1993

<sup>1771</sup> AQSH, faqe 14, viti 1943, dosja 11.

<sup>1772</sup> Shih: Dedijer, V: “Jugoslovensko-albanski odnosi 1939-1948”, Beograd 1949, faqe 92-93.

sive të “Ballit Kombëtar” ku thuhej shkurt e trup: “kush nuk dëshiron me ne, është kundër nesh”.<sup>1773</sup>

Ishte pra fjala për një ultimatum me të cilin komunistët shqiptarë, me urdhrin e Jugosllavëve, duke u vu kushte të papranueshme, që ishin edhe kundër qëndrimit të aleatëve për luftë të përbashkët antifashiste, u kishin shpallur luftën nacionalistëve shqiptarë.

Natyrisht se kjo shpallje lufte, në radhë të parë vlente për “Ballin Kombëtar”, i cili kishte mbështetje në popull dhe kishte filluar të konsolidonte radhët e veta edhe me njësi lufte, ndonëse edhe më tutje hezitonte që të hynte në luftë të hapur me Gjermanët. Ndaj, ishte më se e qartë pse teli rrihte në drejtim të tyre, në përputhje me strategjinë që ata të trajtoheshin “të dyshimtë” dhe madje “bashkëpunëtorë të fashistëve”. Kjo nënkuptonte përjashtimin e tyre nga Fronti Antifashist Shqiptar, për të cilin ishin shumë të interesuar Fuqitë Aleate.

Kjo u pasqyrua edhe nga kritika që Svetozar Vukmanoviq-Tempo, anëtarë i Byrosë Politike të KQ të PK të Jugosllavisë, anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ të Jugosllavisë dhe i dërguar i Komitetit Qendror të PKJ në Shqipëri, i cili njëherësh punonte edhe për projektin e një shtabi ballkanik dhe të një konfederate ballkanike nën drejtimin e Jugosllavisë, i cili ia drejtoi udhëheqjes së PKSH, të cilën e quajti oportuniste ndaj Ballit Kombëtar. Edhe Tempo, gjithnjë me direktivat e Titos, nxitoi që në Kucakë të Korçës, në gusht të vitit 1943, të thërrasëmbledhjen e KQ të PKSH. Aty do të kërkohet dënimi i marrëveshjeve të Mukjes dhe rishikimi i bashkëpunimit me “Ballin”.<sup>1774</sup>

Edhe me këtë rast, siç veproi ditë më parë para Milladinit dhe Dushanit, E. Hoxha, kërkoi falje duke ua hedhur “fajin” Dishnicës dhe Gjinishit, të cilëve Mugosha tashmë ua kishte “bërë gjyqin”.

“Y. Dishnica i shkeli porositë e Komitetit Qendror dhe nuk mbrojti vijën e Partisë. Ai kapitulloi para presionit të borgjezisë reaksionare, duke krye këtu një akt tradhtie.”<sup>1775</sup>

Kështu, Enveri, para Tempos, denoncoi haptas marrëveshjen e Mukjes dhe premtoi se nuk do të paraqiten më gabime të tilla “tradhtie”.<sup>1776</sup>

Y. Dishnica, duke demantuar pohimet e Hoxhës, se “nuk kishte zbatuar udhëzimet e partisë”, thotë se kishte “zbatuar detyrën dhe udhëzimet e Këshillit të Përgjith-

---

<sup>1773</sup> Shih: Mugosha, Dushan: “Shënime nga Shqipëria 1941-1944”.

<sup>1774</sup> Dedijer.V: “Jugoslovensko-albanski odnosi 1939-1948”, Beograd 1949, faqe 93.

<sup>1775</sup> Shih raportin e E. Hoxhës në Aktivin e PK për Tiranën, 15 shtator 1943.

<sup>1776</sup> Po aty.

shëm Nacionalçlirimtar”, njëherësh u jep përgjigje disa interpretimeve të mëvonshme që Hoxha ua ka bërë këtyre ngjarjeve, duke i paraqitur “diç me të buta” dhe gjoja çështje “të strategjisë” dhe jo diktat i jugosllavëve, të cilit ai dhe komunistët shqiptarë i ishin nënshtruar vullnetshëm, duke shkuar një hap tutje.<sup>1777</sup>

Se retushimet që do t’ua bëjë më vonë E. Hoxha disa qëndrimeve rreth Mukjes si dhe raporteve me “Ballin Kombëtar” kahun e të cilave, së paku nga Mukja e këndeje ua kishin përcaktuar jugosllavët, këtë e vërteton edhe ajo që merret si “kundërpërgjigje” e komunistëve shqiptarë Mukjes, nën diktatin e jugosllavëve, këtë do ta dëshmojë Konferenca e Dytë Nacional Çlirimtare në Labinot më 4-8 shtator 1943, me ç’rast jugosllavët ndërtuan strukturat dhe përcaktuan vijën politike të PKS.H.

Në këtë Konferencë, krahas denoncimit partiak të marrëveshjes së Mukjes dhe shpalljes së saj të pavlefshme, me arsyetimin se “është në kundërshtim me interesat e PKS.H e të luftës”, u vendos që t’i shpallej luftë “Ballit Kombëtar”, me të cilin për disa kohë kishte pasur bashkëpunim solid. Pra, vendimi i Konferencës së Labinotit që pushteti i Këshillit Nacionalçlirimtar të ishte pushteti i vetëm, hapte rrugën e një sistemi njëpartiak dhe të një pushteti totalitar në Shqipëri.<sup>1778</sup>

Kështu, prishja e marrëveshjes së Mukjes, jo vetëm që i dha grusht një qëndrimi të drejtë, siç ishte bashkimi kombëtar, të cilin duhej ta rikonfirmonte lufta e përbashkët antifashiste e të gjitha forcave politike shqiptare, por hapi edhe faqen tjetër, atë tragjike, të luftës civile në Shqipëri dhe midis Shqiptarëve në përgjithësi mbi baza të ndasive ideologjike. Me këtë rast jugosllavëve iu mundësua realizimi i qëllimeve të tyre ndaj Shqiptarëve dhe Shqipërisë. Kjo luftë qytetare, si do të shihet, do të ketë për pasojë një tragjedi tjetër shqiptare, siç ishte ajo që filloi me marrjen e pushtetit nga komunistët, së cilës çmimin më të madh ia pagoi Kosova, duke e rikthyer nën pushtimin e Beogradit.

Dështimi i Mukjes dhe ato që do të shfaqen si përçarje të brendshme shqiptare që do të shkojnë edhe deri tek lufta vëllavrasëse - e treta me radhë, pas asaj që kishte ndodhur në vitet 1914-1915 dhe në vitin 1924 - së pari me grushtshtetin islamik-proturk dhe pastaj me grusht-shtetin e qershorit të së majtës kundër qeverisë së Zogut - do të kushtëzohen nga dy faktorë dominues, që do të ndikojnë edhe në ngjarjet e mëtejshme, të cilat do t’ua përcaktojnë kahun ndasive shqiptare po edhe zhvillimeve të tjera me të cilat Shqiptarët do të mbeteshin në bllokun lindor.

---

<sup>1777</sup> Shih: Butka, Uran “Mukja...”, faqe 100.

<sup>1778</sup> Po aty.

Faktori i parë ka të bëjë me ndikimin e madh të komunistëve jugosllavë tek e majta shqiptare dhe Partia Komuniste Shqiptare si produkt i saj politik dhe ideologjik, e cila gjatë luftës dhe pas saj do të kthehet në një filiale të Beogradit, që do të mbikëqyret por edhe do të shndërrohet në një vasale të plotë, e cila, si dihet, militantizmit ideologjik ishte në gjendje që t'ia sakrifikojë çdo gjë: nga interesat kombëtare, siç ishin ato që kishin të bënin me realitetet që prodhoi Lufta e Dytë Botërore që duhej mbrojtur; çështjen e Kosovës (duke ia lënë me dëshirë jugosllavëve, duke u bërë pjesëmarrës në tragjedinë e saj të thellë me më shumë se 50 mijë viktima), e deri te sakrifikimi i shtetit, siç ndodhi nga viti 1945-1948 kur komunistët jugosllavë luteshin që Shqipëria të bëhej republikë e shtatë e Jugosllavisë!<sup>1779</sup>

Faktori i dytë lidhet me paaftësinë e të djathtës shqiptare dhe forcave të tjera të shkapërderdhura patriotike shqiptare, që t'ia dalin që me luftë aktive të kthehen në bartës të frontit antifashist, për ta kthyer atë në një lëvizje demokratike që do të fitonte besimin e plotë të anglo-amerikanëve. Në mungesë të saj, do të fitojë Fronti Nacionalçlirimtar, i drejtuar nga komunistët, i cili karakterin çlirimtar dhe nacional të lëvizjes do ta zëvendësojë me atë të luftës së klasave dhe të ideologjisë komuniste, me çka në fund të luftës, do t'i mundësohet restaurimit të diktaturës komuniste dhe rreshtimit të Shqipërisë në bllokun socialist, me pasojë tragjike për Shqiptarët.

Sa i përket çështje së parë, rreth rolit të madh të komunistëve jugosllavë në Partinë Komuniste të Shqipërisë dhe të drejtimit të saj që nga fillimi e deri në fund, kjo ka të bëjë me përvojën e madhe të komunistëve jugosllavë dhe rolin që luanin në lëvizjen internacionaliste si dhe në vetë strukturat e larta të Kominternit. Atyre do t'u besohej "kapuçi" ndaj komunistëve shqiptarë, që do të pasqyrohet më së miri, me rolin që do ta luajnë ata gjatë kohës përgatitore kur në Shqipëri do të dërgojnë kuadrot e veta Milladin Popoviqin (Alia) dhe Dushan Mugoshën (Sala), dy malazias nga Kosova. I pari përfaqësues i drejtpërdrejtë i Titos, ndërsa i dyti përfaqësues i të ashtuquajturës bazë partiake nga Kosova - një serbomadh me maskën komuniste, që si do të shihet, do të bëjë shumë që Enver Hoxha dhe komunistët e tjerë shqiptarë të zhvishen nga çdo ide që Kosova dhe viset e tjera shqiptare të ruanin të drejtën e bashkimit me Shqipërinë. Kjo bëhej edhe jashtë qëndrimeve që kishin nxjerrë komunistët jugosllavë në Kongresin e Dresdenit më 1928 rreth asaj se "Jugosllavia e Versajës ishte burg popujsh që duhej rrënuar" dhe me këtë rast edhe Shqiptarëve u

---

<sup>1779</sup> Më gjerësisht rreth kërkesës së komunistëve të Shqipërisë që Shqipëria të bëhet republikë e shtatë e Jugosllavisë shih këta autorë: Dedijer, Vladimir: "Jugoslovensko-albanski odnosi 1939-1948", Beograd 1949; Hadri, Ali: "Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave", Prishtinë 2003; Mugosha, Dushan: "Shënime nga Shqipëria 1941-1944", Vukmanović, Svetozar-Tempo: "Memoari" I, II, Beograd-Zagreb 1966-1969; Đaković, Spasoje: "Knji-ga o Kosovu", Beograd 1984.

takonte e drejta për shtet të përbashkët, dhe jashtë qëndrimit të Kominternit për të drejtën e njohjen e vetëvendosjes së popujve të shtypur.<sup>1780</sup>

Komunistët jugosllavë, që do të marrin pjesë jo vetëm në themelimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë, në nëntor të vitit 1941, por edhe në organizimin e Shtabit të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe në të gjitha strukturat e tjera të Këshillave Nacionalçlirimtare që do të themelohen prej komunistëve dhe ato do të luajnë edhe rolin e pushtetit vendor, do të kenë fjalën kryesore rreth çështjeve më të rëndësishme të brendshme dhe të jashtme. Ata, madje do të përcaktojnë edhe kornizat nëpër të cilat duhej të silleshin komunistët shqiptarë, të cilët, në frontin politik dhe atë të luftës nuk duhej të paraqiteshin bashkërisht, në përputhje me atë që Shqipëria në të vërtetë paraqiste - si e bashkuar, por që organizimi i tyre politik dhe ai ushtarak duhej të ndiqte strukturat e shtetit tashmë të rrënuar jugosllav, ku për Shqiptarët edhe më tutje duhej të vlente kufiri i Versajës.

Kjo ndarje do të ketë pasoja të mëdha, sepse fronti antifashist shqiptar i udhëhequr nga Nacionalçlirimtarja do të shfaqej i ndarë në dy pjesë: në atë që formalisht udhëhiqnin komunistët shqiptarë të mbikëqyrur nga Jugosllavët (brenda kufijve të Shqipërisë së Versajës), dhe atë, që udhëhiqej nga komunistët e Kosovës, të cilët, ndonëse formalisht ishin të lidhur me Partinë Komuniste të Jugosllavisë dhe me strukturat e atjeshme të Luftës Nacionalçlirimtare, praktikisht vepronin të pavarur. Kjo do të ndodhë nga fillimet e deri me rastin e largimit të Gjermanëve, në nëntor 1944, kur pas futjes së brigadave shqiptare në Kosovë (të tretës dhe të pestës – gjithnjë sipas direktivave të Jugosllavëve), do të pasojnë suprimimi dhe madje edhe “gëlltitja” e brigadave kosovare nga ato jugosllave dhe serbe, të shumtën me formacione çetnike të konvertuara në “partizanë”.

Para se të ndodhë kjo, partizanët kosovarë luftonin nën flamurin kombëtar shqiptar, që jo gjithnjë shoqërohej edhe me atë komunist! Midis tyre kishte patriotë me bindje majtiste, të cilët nuk i besonin komunizmit as jugosllavëve, por ishin të vetëdijshëm se në ato rrethana duhej bërë çmos që e majta shqiptare të pozicionohej konform aleancës antifashiste për ta siguruar të drejtën e vetëvendosjes në përputhje me Kartën e Atlantikut. Të tillët do të përpiqen që ta pavarësojnë lëvizjen antifashiste në Kosovë sa më shumë që të jetë e mundur, por në këtë rrugë ata do të kundërshtohen energjikisht nga komunistët shqiptarë, të cilët nis e sos zbatonin urdhrat e jugosllavëve. Kështu, edhe marrëveshja e Mukjes, e cila me të shpejtë do të priset nga komunistët shqiptarë, siç do të prishen edhe disa nga

---

<sup>1780</sup> Më gjerësisht shih Vladimir Dedijer: “*Novi prilozi za biografiju Josipa Broza Tita*”, vëllimi i tretë, Beograd.

pikat strategjike të bashkëpunimit me Anglo-Amerikanët dhe ndihmën që duhej marrë prej tyre në fazën e fundit të luftës, me çka lëvizja antifashiste në Shqipëri të ruante përkatësinë perëndimore ndaj asaj lindore, e kanë burimin te ndërhyrjet e ashpra të këshilltarëve jugosllavë tek Enveri, të cilin e mbanin të lidhur për vete dhe larg çfarëdo mundësie që të ndikohej nga nacionalistët shqiptarë dhe fronti patriotik, të cilët ishin të lidhur me idenë e bashkimit kombëtar. Madje edhe atëherë kur Enveri, i frikësuar nga rritja e ndikimit të frontit patriotik shqiptar dhe të mbështetjes që fitonte nga Anglo-Amerikanët, do të kërkojë sqarime nga Tito siduhej vepruar rreth çështjes së Kosovës dhe fatit të saj, meqë ajo paraqiste një çështje të rëndësishme për bashkimin e masave në frontin e përbashkët antifashist.<sup>1781</sup>

Rreth marrëveshjeve të Mukjes, por edhe rreth tolerimit të prirjeve të disa komunistëve kosovarë të cilët luftën antifashiste e lidhin vazhdimisht me përgjigjen e drejtë që ajo duhej t'i jepte çështjes së Kosovës, siç u pa, Enveri do të bëjë një autokritikë “të sinqertë komuniste” para Milladin Popoviqit dhe Dushan Mughoshës. Ai do t'ua pranojë “*se ishin disa oportunistë nga radhët e frontit (Dishnica dhe Gjinishi), të cilët do të bëjnë që të pranohet hilja e ballistëve për udhëheqje të përbashkët dhe për pranimin e idesë së Shqipërisë së madhe*”, me të cilën komunistët shqiptarë nuk do të pajtohen kurrë, meqë sipas Enverit “*ajo ishte krijesë fashiste që duhej luftuar*”.<sup>1782</sup>

Këtu dhe te kjo çështje do të zënë fill edhe problemet midis komunistëve shqiptarë në njërën anë dhe të atyre nga Kosova, në tjetrën anë, të cilat do të sjellin edhe tek zhvlerësimi i vendimeve të Konferencës së Bujanit, të 31 dhjetorit 1943 dhe 1 e 2 janarit 1944, në qershor të vitit 1945 në Kuvendin e Prizrenit. Me këtë do t'i jepej drita e gjelbër edhe një robërie tjetër të Kosovës nën Jugosllavët, por tash nën firmën e internacionalizmit komunist dhe të platformës së ideolo-

---

<sup>1781</sup> Shih letrën e Ivan Millutinoviçit drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë më 25 tetor 1943, me ç'rast ai komunistëve shqiptarë ua sjell porosinë e Titos lidhur me qëndrimin që duhej mbajtur rreth çështjes së bashkimit shqiptar dhe kërkesës së nacionalistëve shqiptarë që ajo të kthehet në deklaram kryesor të frontit antifashist. Në letër pos të tjerash thuhet:

*“Sërish po ua bëj me dije se nuk duhet të merrni qëndrim të njëjtë me atë që po e merr borgjezia reaksionare shqiptare, ku theksohej se Kosova qysh tash duhet t'i bashkohet Shqipërisë, por që asaj duhet dhënë përgjigje të përbashkët, pasi që bashkërisht të kemi fituar luftën kundër okupatorëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre, në mënyrë që më vonë popujt të deklarohen çfarë donë dhe nga dëshirojnë të shkojnë”.*

Sipas Spasoje Gjakoviqit, bashkëpjesëmarrës i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës, me rastin e hapjes së kësaj çështje, që të dërguarit e Enver Hoxhës do t'ia paraqesin Ivan Millutinoviçit, bashkëpunëtorit të ngushtë të Titos, kur ai ndodhej në Mal të Zi, do të deklarojë se “*sa i përket Kosovës, Enver Hoxha edhe më tutje nuk ishte liruar nga bindja se ajo duhet t'i takojë Shqipërisë*”, dhe se me këtë rast, Tito do të shfrytëzojë rastin që për herë të fundit t'ia tërheq vërejtjen të heqë dorë nga kjo ide. (Cituar sipas Spasoje Djaković “*Sukobi na Kosovu*”, Beograd, 1984, faqe 398).

<sup>1782</sup> Po aty, faqe 207.

gjisë së vëllazërim-bashkimit, me të cilën, manipulohej si për një “formulë magjike” për zgjidhjen e të gjitha çështjeve dhe problemeve “*të trashëguara nga politika imperialiste dhe shoviniste*”, që kritikohet me gjithë zërin dhe fajësohet për telashet e lëna, por pa denjuar me asgjë që pasojat të korrigjoheshin duke u nisur nga eliminimi i shkakut, pra politika imperialiste dhe hegjemoniste jugosllave ndaj Shqiptarëve që kishte drejtuar Beogradi në vazhdimësi.

Përkundrazi, komunistët jugosllavë, nën maskën e formulave demagogjike, do t’ia dalin jo vetëm që në Kosovë të kthejnë strukturën shtetërore që kishte Jugosllavia e Versajës, por në të njëjtën kohë, nën parullat e vëllazërim-bashkimit dhe të ideologjisë komuniste si farsë, do t’u shkojë për dore që të rikthejnë peshën hegjemoniste që Serbët kishin në kohën e Mbretërisë Jugosllave, që si do të shihet, pas gjysmë shekulli dominim këtij shteti do t’i kthehet në sëmundje vdekjeprurëse.

## LIDHJA E DYTË E PRIZRENIT DHE SHTETI I PAVARUR SHQIPTAR

Kapitullimi i Italisë fashiste, më 8 shtator 1943 nuk ishte i papritur. Ushtria italiane nuk ishte e gatshme për luftë as kur filloi Lufta e Dytë Botërore. Këtë e kishte të qartë edhe Vermahti, por asaj i duhej një aleat i tillë, të cilit do t’i ruhej fuqia luftarake me ato të aleatëve të tjerë nga radhët e vendeve kuislinge. Nga fundi i vitit 1942 dhe fillimet e vitit 1943, për Hitlerin shqetësim më të madh paraqiste mënyra si do të plotësohej vakuumi italian se sa kapitullimi i aleatit të saj kryesor. Sa i përket hapësirës ballkanike me një rol të rëndësishëm në mbajtjen e frontit juglindor dhe atij lindor, Gjermanët mbronin qëndrimin se duhej shpallur Shqipërinë shtet të pavarur, meqë ajo rikthente balancimet e duhura gjeostrategjike dhe gjeopolitike në rajon në përputhje me interesat e Fuqive të Boshtit. Ministri i jashtëm gjerman, Ribentrop, ia kishte paraqitur planin Hitlerit se formimi i një qeverie kombëtare shqiptare, e cila “si e tillë do të jetë e aftë për bisedime dhe do të ketë qëndrim pozitiv ndaj nesh”.<sup>1783</sup>

Këtë qëndrim Ribentrop e kishte në saje të një analize të Shtabit Operativ të Vermahtit, në të cilën thuhet se “Shqiptarët kërkojnë pavarësinë e tyre shtetërore. Ai që ua sjell, ai është mik i tyre. Duhet pritur se Anglo-Amerikanët, me rastin e parë të përshtatshëm, do ta shpallin pavarësinë shqiptare. Për këtë arsye duket se është shumë e ngutshme që nga ana gjermane të shpallet sa më parë një

<sup>1783</sup> Hass, Gerhard/Schuman, Wolfgang: “*Anatomi der Agession – Neue Dokumente zu den Kriegszielen der faschistischen deutschen Imperialismus in Zweiten Weltkrieg*”, Berlin, 1972, faqe 120.

deklaratë e këtillë, në mënyrë që të pengohej që Shqiptarët të kthehen në anën e armikut”<sup>1784</sup>.

Me këtë rast Ribentropi i dha udhëzime ambasadorit në Romë dhe konsullin të përgjithshëm në Tiranë, ku theksonte nevojën e marrjes së një vendimi politik mbi qëndrimin e ardhshëm ndaj Shqipërisë, i cili do të jetë i dobishëm nga aspekti ushtarak. Një shtet shqiptar i pavarur, do të jetë në gjendje që Gjermanisë t’ia sigurojë mbrojtjen e bregdetit shqiptar, sidomos rrugët e Otrantit, ndërkohë që ky shtet, jo vetëm që do ta qetësonte politikisht Shqipërinë, por atë do ta kthente në një mbështetës tonë të fortë, ku forcat tona do të jenë fare të pakta, por shumë të sigurta.<sup>1785</sup>

Me këto udhëzime vepronte edhe i autorizuari i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Gjermanisë për Ballkanin (me seli në Beograd), Herman Neubacher (Noj-baher). Në fillim të shtatorit ai vuri lidhje me autoritetet shqiptare: Ibrahim Biçokun, Xhafer Devën, Vehbi Frashërin dhe Shqiptarët e tjerë që konsideroheshin progjermanë, që kishte pranë, në mënyrë që qeveria e re e shtetit të pavarur shqiptar të ishte progjermane.

Menjëherë pas kapitullimit të Italisë, më 9 shtator 1943, trupat gjermane i çarmatosën trupat italiane në gjithë Shqipërinë. Përgatitjet për këtë veprim, Gjermanët i kishin kryer më kohë gjatë muajit gusht, kur komanda gjermane ia kishte arritur të instalonte në pikat strategjike të vendit numër të konsiderueshëm forcash ushtarake në fushat e aviacionit në Tiranë, në Shkodrë, Berat, Vlorë, Kuçovë dhe gjetiu. Vlerësohej se ky numër arrinte në 6 mijë veta. Pas riorganizimit të Vermahtit në Ballkan, me ç’rast u krijua grupi i forcave tokësore “F” me qendër në Beograd nën komandën e feldmareshalit Von Vajks, në të njëjtën kohë komanda e lartë Vermahtit urdhëroi afrimin e forcave të caktuara ushtarake pranë kufijve të Shqipërisë për të marshuar, siç ishte Korpusi XXI, Divizioni 297-të i këmbësisë, që u përqendruan në rajonin e Mitrovicës.

Kështu, më 9 shtator, repartet e para gjermane nisën lëvizjen në thellësi të Shqipërisë: Divizioni 297 nga Mitrovica në Prishtinë, në Kukës e në Shkodër; Divizioni i 100-të nga Ohri në Strugë, Elbasan, në Tiranë e në Durrës. Trupat gjermane morën urdhër të çarmatosnin menjëherë ushtrinë italiane dhe të shtrihe-shin në gjithë vendin.<sup>1786</sup>

---

<sup>1784</sup> Po aty, faqe 119.

<sup>1785</sup> Po aty.

<sup>1786</sup> “*Historia e Popullit Shqiptar*”, vëllimi IV, Tiranë 2008, faqe 77.



Në Kosovë dhe në Maqedoni trupat gjermane depërtuan pa kurrfarë pengese. Në pjesë të ndryshme ardhja e tyre u përshëndet nga paria e vendit, e cila nuk ishte e kënaqur me ushtrinë italiane, e cila kishte filluar të sillej me ashpërsi ndaj manifestimeve patriotike, duke përndjekur nacionalistët. Edhe pse Këshilli i Përgjithshëm i Nacionalçlirimtar dhe Shtabi i Përgjithshëm Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare kishte lëshuar një thirrje për t'iu kundërvënë ushtrisë gjermane, nuk pati ndonjë reagim të ndjeshëm. U shënuan disa veprime të vogla e ndonjë kundërvënie, siç ishte ajo në Xhyrë, te Ura e Kardhiqit në afërsi të Konispolit dhe në rrugët Korçë-Janinë, ndërkohë që më disa pjesë, në hapësirën e lëshuar nga Italianët, përkohësisht u vendos pushteti i këshillave nacional-çlirimtarë.<sup>1787</sup>

Pavarësisht vështirësive të vogla që hasi ushtria gjermane gjatë vendosjes së saj në të gjitha pjesët e vendit, ditën që ajo u shfaq në Shqipëri po atë ditë, kryekomandanti i trupave gjermane në Shqipëri, gjenerali von Besel, doli me një komunikatë në të cilën thuhej:

*“Me hyrjen e ushtrisë gjermane në tokën tuaj, pavarësia e Shqipërisë do të jetë e sigurtuar, pasi garant do të qëndrojë Rajhu i madh gjerman dhe ushtria ngadhënjyese e tij, e cila kundërshtojë tokës suaj nuk ushqen kurrfarë pretendimesh. Dëshirat tuaja themelore për pavarësi do të realizohen nëpërmjet ndihmës që do t'i jepni ushtrisë gjermane”.*<sup>1788</sup>

Pra, pavarësia mund të realizohej nëpërmjet ndihmës që do t'i jepej ushtrisë gjermane. Gjenerali gjerman këtë ua bëri me dije edhe personaliteteve të rëndësishme të vendit dhe intelektualëve gjatë një takimi në Tiranë. Me këtë rast gjenerali gjerman tërhoqi vërejtjen nga bashkëpunimi i të majtës shqiptare me fqinjët sllavë mbi bazat e ideologjisë komuniste, meqë ashtu bashkoheshin me bolshevizmin rus.

Meqë Gjermania pas kapitullimit të Italisë, në rrethanat e reja të luftës kur humbja e betejës së Stalingradit paraqiste një shqetësim tjetër të madh ushtarak për Hitlerin, duhej të rishqyronte pozitën strategjike në Ballkan dhe Mediteran, ku Shqipëria dhe hapësira e saj shfaqej me rëndësi të madhe, ishte e domosdoshme që kjo pozitë të përcillej edhe me një tretman tjetër politik të Shqipërisë, në mënyrë që ajo të mos kthehej në brengë të saj, por në një vend të sigurt dhe me stabilitet për Gjermanët. Kjo nënkuptonte përmirësimin e statusit shoqëror dhe politik të saj në raport me atë që kishte në kohën Italisë, me ç'rast, siç u tha, në Berlin doli ideja që Shqipërisë t'i njihej statusi i një vendi “me pavarësi relative” dhe “sovrانيتet të kufizuar”.

---

<sup>1787</sup> Po aty.

<sup>1788</sup> “Historia e Popullit Shqiptar”, vëllimi i dytë, Prishtinë, 1969, faqe 721.

Projekti gjerman për statusin e Shqipërisë mbështetej kryesisht te ideja që qeverisja duhej të ishte shqiptare e zgjedhur nga vetë Shqiptarët, pra në një shtet shqiptar, ku bashkimi shqiptar krahasuar me atë italian, do të përmirësohej dhe institucionalizohej në përputhje me qëndrimin shqiptar rreth kësaj çështje si dhe realiteteve të saj etnike në formën e një “Shqipërie Etnike”, në të cilën do të përfshihej edhe Mitrovica dhe viset tjera, që deri më atëherë ishin lënë jashtë.

“Shqipëria Etnike”, ku përfshihej Kosova dhe një pjesë tjetër e viseve shqiptare, që nuk kishin gjetur vend në “Shqipërinë e Madhe” të krijuar nga fashizmi italian, jo vetëm që kishte mbështetje nga pjesa më e madh e Shqiptarëve, por kërkohesh që ajo të jetësohej sa më shpejt. Kjo u shkante për shtati edhe Gjermanëve, të cilët ishin të interesuar sa më parë të stabilizonin gjendjen ushtarake në këtë pjesë tepër strategjike.

Që të mos krijohesh vakum institucional dhe shtetëror dhe që të rrënoheshin strukturat që kishte krijuar fashizmi italian i cili kishte kapitulluar, më 16 tetor në Tiranë u thirr Asambleja Kombëtare, e përbërë nga intelektualë të njohur, përfaqësues të kapitalit, përfaqësues të krahinave si dhe klerikë. Asambleja Kombëtare mori një vendim të rëndësishëm: shpalli ndarjen e Shqipërisë nga Italia dhe caktoi Këshillin e Lartë të Regjencës me Mehdi Frashërin në krye në përbërjen e të cilit ishin Lef Nosi, Anton Arapi dhe Fuat Dibra.

Në një njoftim për Ministrinë e Jashtme, Nojbaheer, theksonte se “kemi ndërmarrë hapa që të formojmë një komitet nacional” dhe se “përpjekjet tona i kemi orientuar në atë drejtim që ky komitet të proklamojë pavarësinë e Shqipërisë dhe të mbledh Kuvendin Kombëtar, nga i cili do të dalë qeveria dhe organet tjera shtetërore”. Në këtë njoftim, po ashtu bëhet me dije, se “në këto çaste vendimtare Shqiptarët duhet të marrin vetë iniciativën në dorë, e se hapat që do të heqin, do të kenë mbështetjen e plotë të Gjermanisë”.<sup>1789</sup>

Më 5 nëntor Regjenca emëroi qeverinë në krye me Rexhep Mitrovicën, patriotin e njohur kosovar, që kishte marrë pjesë në shpalljen e pavarësisë në Vlorë më 1912. Si kundërshtar i Zogut kishte qëndruar në emigrim, ndërsa me pushtimin e vendit nga Italia fashiste ishte kthyer dhe caktuar anëtar i Këshillit të Shtetit. Në qeverinë e Rexhep Mitrovicës bënë pjesë: Xhafer Deva - ministër i punëve të brendshme; Vehbi Frashëri, i biri i Mehdi Frashërit - ministër i jashtëm; Rrok Kolaj - ministër i drejtësisë; Sokrat Dodbiba - ministër i financave; Ago Agaj - ministër i ekonomisë dhe Musa Gjylberku - ministër i punës. Në shkurt 1944

---

<sup>1789</sup> “Historia e Popullit Shqiptar”, IV, Tiranë 2008, faqe 82.

qeveria e R. Mitrovicës u plotësua edhe me tre ministra nga radhët e “Ballit Kombëtar”: Bahri Omari- ministër i jashtëm, Koço Muka- ministër i arsimit dhe Kolë Tomara- ministër i kulturës. Në Regjencë hynë edhe Lef Nosi, Bahri Omari, Kolë Tomora, Anton Harapi dhe të tjerë.<sup>1790</sup>

Këshilli i Regjencës së Lartë dhe qeveria e dalë prej saj, do të kenë mbështetje nga të gjitha shtresat shoqërore shqiptare, me përjashtim të komunistëve. Meqë ajo drejtohej nga intelektualë dhe atdhetarë të njohur siç ishte Mehdi Frashëri, dhe në të do të hyjnë edhe përfaqësuesit e “Ballit Kombëtar” dhe të “Legalitetit”, ishte krijuar një rast që Shqiptarët, të çliruar nga pushtimi italian, të zhvillonin një politikë të kujdesshme kombëtare të ekuilibruar. Sado që në ato rrethana kjo dukej e vështirë, veçmas kur dihej se “hapësira neutrale”, midis frontit fashist dhe atij antifashist, që i duhej shtetit shqiptar për të mbijetuar, jo vetëm që po ngushtohej, por ajo domosdoshmërisht kërkonte përcaktimin për njërën anë.

Në këso shtate, megjithatë, Gjermania i kushtonte vëmendje të veçantë Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare (Maqedonisë), që kishin qenë nën pushtimin jugosllav. Duke ditur këtë, ajo jo rastësisht, angazhoi intelektualët dhe forcat politike nga këto pjesë në qeverinë shqiptare dhe në strukturat e tjera administrative dhe shtetërore dhe kjo u dha shtytje të reja lëvizjeve patriotike për bashkim kombëtar, ku ishin përfshirë një pjesë e madhe intelektualëve kosovarë për të cilët e rëndësishme ishte, që cilado qofshin rrethanat e luftës nëpër të cilat po kalonte bota, duhej të shfrytëzoheshin për këtë çështje. Ndaj, lëvizja nacionaliste në Kosovë (me të nënkuptohej edhe ajo në viset shqiptare në Maqedoni që administrativisht dhe politikisht kishin qenë të ndërlidhura gjatë pushtimit serb dhe atij jugosllav, me të kapitulluar Italia fashiste, nxitoi të marrë në dorëzim administratën e vendit nëpër të gjitha qendrat e prefekturave dhe nënprefekturave autonome-ekzekutive. Ky veprim, bashkë me çarmatimin e trupave italiane dhe marrjen e depove të armatimit në të gjitha qendrat, u përmbyll me sukses brenda dy ditësh, sado që në disa pjesë pati përpjekje të çetave komuniste të ndërhyenin për hesapin e tyre. Kjo nuk u lejua nga nacionalistët. Ata, tashmë e kishin gjithnjë e më qartë, se ishte koha që këtij ndryshim të madh t’i jepej një përgjigje nga Shqiptarët në përputhje me interesat kombëtare. Ndër ato interesa dy ishin më të rëndësishmet: shpëtimi i vendit nga rreziku sllavo-komunist si dhe mbajtja e bashkimit kombëtar në binarët tashmë të

---

<sup>1790</sup> Po aty, faqe 85.

filluar në atë mënyrë që të rrumbullakohet sa më shumë që të jetë e mundshme duke gjetur përkrahje edhe nga faktori ndërkombëtar.<sup>1791</sup>

Për t'i realizuar këto qëllime, me nismën e një grupi nacionalistësh të përbërë nga Xhafer Deva nga Mitrovica, Musa Shehu e Sheh Hasani nga Prizreni, Asllan Boletini nga Mitrovica, Tahir Zajmi nga Gjakova, Lukë Simon Mjeda nga Prizreni, Qazim Bllaca nga Suhareka dhe Pjetër Vuçaj nga Prizreni, më 11 shtator 1943, në Prizren u mbajt një mbledhje në të cilën u shqyrtua gjendja e krijuar dhe masat që duhej marrë që ajo të shfrytëzohej për realizimin e këtyre interesave kombëtare.<sup>1792</sup>

Në këtë mbledhje u vendos:

- *thirrja e një mbledhjeje të përgjithshme me shpirtin dhe frymën e Lidhjes së Prizrenit, në të cilën nëpërmes delegatëve të zgjedhur nga populli, duhej të përfaqësoheshin të gjitha krahinat e Kosovës, të Dibrës, të Strugës, të Tuzit dhe Ulqinit;*

- *krijimi i këshillave-autonome-ekzekutive, që do të marrin përgjegjësinë e pushtetit vendor dhe të rendit përderisa të themelohet një autoritet suprem nga mbledhja e përgjithshme dhe*

- *ngarkimi i këshillit ekzekutiv të Prizrenit me përgatitjen e mbledhjes së Kuvendit, hapja e të cilit do të bëhej jo më vonë se më 16 shtator 1943.*<sup>1793</sup>

Edhe pse në një afat të shkurtët dukej vështirë përballimi i vështirësive organizative, megjithatë ato u përballuan falë atmosferës së një entuziazmi që kishte shpërthyer në gjithë vendin si dhe përkushtimit patriotik që kësaj sfide historike t'i jepej përgjigjja e duhur.

Ndaj, po atë ditë që në Tiranë do të mbahej Asambleja Kushtetuese, në Prizren në një atmosferë festive të jashtëzakonshme, delegatë nga të gjitha viset shqiptare (nga Kosova, Tetova, Dibra, Gostivari, Ulqini dhe të tjera), u mblodhën në Kuvendin e Dytë të Lidhjes së Prizrenit, kuvend ky që do të paraqiste vazhdimësinë e Kuvendit të Parë të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit të vitit 1878, kur në të vërtetë prej tij kishte dalë edhe Qeveria e parë e një shteti shqiptar pas asaj të Skënderbeut.<sup>1794</sup>

Kuvendi u mbajt në shkollën “Bajram Curri”. U hap në orën 10 me fjalimin e Musa Shehut. Vendimin për thirrjen dhe mbajtjen e Kuvendit të Dytë të Lidhjes së Prizrenit e arsyetoi, duke vënë theksin te detyrat që i presin Shqiptarët në ato rrethana, për të cilat tha se janë ndër më të rëndësishme për fatin e vendit dhe të popullit.

---

<sup>1791</sup> Shih: Zajmi Tahir: “Lidhja II e Prizrenit”, Bruksel, 1964, faqe 33-34.

<sup>1792</sup> Po aty, faqe 35.

<sup>1793</sup> Po aty, faqe 36.

<sup>1794</sup> Më gjerësisht shih Zajmi, Tahir: “Lidhja e Dytë e Prizrenit”, Bruksel, 1964.

Musa Shehu, me këtë rast përkujtoi edhe përgjegjësinë historike që e marrin përsipër intelektualët dhe patriotët kur kjo është e domosdoshme, e që duhet të shtrohet qartë dhe me guxim pa marrë parasysh vështirësitë, rreziqet me të cilat përcillet ajo. Theksoi se qershori i vitit 1878, po ashtu ishte me shumë shqetësim dhe rreziqe, por në Prizren, Shqiptarët e bashkuar, me një mendje dhe me një qëndrim, dhanë betimin për mbrojtjen e trojeve të veta, siç dhanë konceptin politik për Shqipërinë autonome, që duhej t'ia hapte udhën Shqipërisë së Pavarur, në pajtim me rrethanat.

“Shqipërinë e bashkuar nuk duhet ta heqim kurrë nga mendja, e as nga veprimet tona... Edhe sot kemi këtë preokupim, që duhet ta bëjmë të qartë karshi botës...”<sup>1795</sup>

Pas fjalës së Musa Shehut, Kuvendi zgjodhi për kryetar Musa Shehun, nënkryetarë Aqif Blyten dhe Rexhep Krasniqin ndërsa Bedri Gjinajn, sekretar.

Ditën e parë, para Kuvendit, Kryesia doli me një program 6 pikësh:

1. *Bisedim mbi shpalljen e vullnetit popullor për bashkimin e viseve të Kosovës, të Dibrës, të Strugës dhe të Ulqinit e Tuzit si pjesë integrale e Shqipërisë;*
2. *Mbi bashkimin gjithashtu me nanën Shqipëri të krahinave të Mitrovicës, të Vuçitërnës, të Podujevës dhe Pazarit të Ri, që ndodhen nën pushtimin e ushtrisë gjermane, por administrativisht të lidhura me shtetin e Serbisë;*
3. *Mbi organizimi politik dhe ushtarak të popullit dhe përgatitjen embrojtjes së kufijve etnikë;*
4. *Mbi krijimin e një organi ekzekutiv ose Komitetit Qendror me seli në Prizren dhe të nënkomiteteve ndër të gjitha qendrat e tokave të liruara për të drejtuar aktivitetet nevojshme mbi qeverisjen e mbrojtjen e vendit;*
5. *Mbi përpilimin dhe aprovimin e një statuti të Organizatës Kombëtare “Lidhja II e Prizrenit” dhe*
6. *Mbi procedurën që do të ndiqet për zgjedhjen e përfaqësuesve të krahinave të Kosovës, të Dibrës, të Strugës dhe Ulqinit e Tuzit për Kuvendin Kombëtar të Tiranës.*<sup>1796</sup>

Kuvendi i vazhdoi punimet për katër ditë me radhë. I përfundoi më 20 shtator 1943 me miratimin e dokumenteve themelore (statutit dhe proklamatës) me zgjedhjen e Komitetit Qendror të Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Kryetar i Komitetit Qendror të Lidhjes u zgjodh Rexhep Mitrovica, ndërsa nënkryetarë u zgjodhën Musa Shehu dhe KolëMargjini, të dy nga Prizreni, ndërsa Sheh Hasani nga Prizreni, Bedri Pejani nga Peja, Asllan Buletini nga Mitrovica, Tahir Zajmi nga Gjakova dhe

<sup>1795</sup> Po aty.

<sup>1796</sup> Po aty, faqe 40.

Qazim Bllaca nga Suhareka u zgjodhën anëtarë. Në këtë kuvend u caktuan edhe delegatët e viseve shqiptare (Kosovës, Rrafshit të Dukagjinit dhe të Sanxhakut) për mbledhjen e Kuvendit Popullor që duhej të mblidhej më 16 tetor në Tiranë.<sup>1797</sup>

Në Kuvendin e Dytë të Lidhjes së Prizrenit, krahinat e ndryshme të shqiptare u përfaqësuan nga 42 delegatë: Musa Shehu, Sheh Hasani, Lukë Simon Mjeda dhe Qemal Karahoda (*Prizren*), Sulejman Kryeziu dhe Hasan Dashi (*Gjakovë*), Tahir Zajmi (*Kukës*), Halim Shuku (*Ferizaj*), Bejtullah Haxhiu (*Rahovec*); Nuredin Haliti, Qazim Bllaca (*Suharekë*), Haxhi Xheladini (*Shkup*), Nexhip Basha, Xhevat Begolli (*Pejë*), Bajram Gashi (*Plavë*), Shemsi Feri (*Rozhajë*), Adem Kurtaga (*Prishtinë*) Mahmut Shabanpasha dhe Jusuf Agushi (*Gjilan*), Mehmet Devaja dhe Esad Berisha (*Mitrovicë*), Asllan Boletini, Bedri Gjinaj (*Pazari i Ri*), Aqif Blyta (*Senicë*), Hasan Zvezdiq, Vehbi Hamzagaj (*Bicaj*), Lutfi Spahiu (*Malësi e Gjakovës*), Bajram Haziri (*Strugë*), Mentor Çoka (*Ulqin*), Safet Ulqini (*Dibër*), Rustem Ymeri dhe Shahin Cami (*Tetovë*), Ismet Lusha dhe Jusuf Jaga (*Gostivar*), Remzi Ragibi, Rexh Meta (*Vuthaj*). Ndërsa si kosovarë me qëndrim në Shqipëri nga viti 1913 u zgjodhën: Rexhep Mitrovica, Bedri Pejani, Xhafer Deva, Xhelal Mitrovica dhe Maz'har Sopot.<sup>1798</sup>

Njëri nga qëllimet kryesore të Lidhjes së Dytë Shqiptare të Prizrenit ishte arritja e tubimit të të gjithë Shqiptarëve në një shtet, të cilit do t'i takonin Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit, Sanxhaku dhe pjesët lindore të Malit të Zi, pjesët perëndimore të Maqedonisë, viset e Novi-Pazarit si dhe në Jug (Pika II e Statutit).<sup>1799</sup>

Këtij qëllimi i nënshtrohej edhe Statuti i organizimit të vetë Lidhjes nëpër degë dhe nëndegë si dhe veprimtarinë e organizatës, që duhet të jetë në përputhje me programin (pika IV), ku njëra ndër detyrat kryesore të Lidhjes ishte formimi i një-sive ushtarake të cilat do t'i shërbenin përmbushjes së këtyre qëllimeve (pika VI). Pika XI përcakton edhe karakterin e një-sive ushtarake rezervë, të cilat mbahen në stërvitje të vazhdueshme për të qenë të gatshme të vihen në mbrojtje të vendit.<sup>1800</sup>

Në përputhje me Statutin e Lidhjes, qeveria e Rexhep Mitrovicës, nën përkujdesjen e ministrit të punëve të brendshme, Xhafer Devës, filloi mobilizimin dhe formimin e divizionit “Skënderbeg”, i cili do të përfshihej në luftimet kundër forcave çetnike dhe komuniste në këtë pjesë.

---

<sup>1797</sup> Po aty, faqe 43.

<sup>1798</sup> Po aty.

<sup>1799</sup> Statuti i “Lidhjes II të Prizrenit”, faqe 1.

<sup>1800</sup> Po aty, faqe 49.

Këshilli i Naltë i Shtetit Shqiptar, mbi propozimin e bërë me shkresën nr. 324 datë 12 shkurt 1944, më 14 mars 1944, aprovoi Statutin e Organizatës Lidhja II e Prizrenit”. Dekreti u nënshkrua nga Kryetari Mehdi Frashëri dhe Kryeministri Rexhep Mitrovica.<sup>1801</sup>

Në këtë mënyrë, edhe zyrtarisht, “*Lidhja II e Prizrenit*” u kthye në platformë politike të shtetit të ri të bashkuar shqiptar, me anën e të cilit i sigurohej jo vetëm deklarimi i vullnetshëm i popullatës së bashkuar, por edhe struktura administrative dhe ato mbrojtëse, të cilat duhej të viheshin në shërbim të shtetit shqiptar, kufijtë e të cilit kërcënoheshin e cenoheshin vazhdimisht nga çetnikët e Draža Mihajloviqit, por edhe brigadat komuniste serbe, malaziase dhe bullgare, ku nuk përjashtoheshin edhe aleatët e tyre nga radhët shqiptare.

## PJESA E PESTË

# RIKTHIMI I JUGOSLLAVISË

---

<sup>1801</sup> Po aty, faqe 51.





## KAPITULLI I PARË

### RIPUSHTIMI I KOSOVËS DHE I MAQEDONISË

#### REZISTENCA KOBËTARE KUNDËR PARTIZANËVE JUGOSLLAVO-SHQIPTARË

Në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore, në vitet e kthesave të mëdha 1943-1944, krahas realitetit antifashist dhe të shtrirjes së organizimit të tij në vend me anën e Këshillave Nacionalçlirimtare, i cili, pa ndonjë ndikim dhe herëherë i pavërejtur fare shtrihej jashtë sferave urbane dhe të shumtën ishte i natyrës ilegale, ekzistonte pushteti real i Shtetit Shqiptar. Në planin institucional ai përfshinte jetën shoqërore, administrative, ushtarak dhe politike të vendit në formën e një mekanizmi të përbashkët. Ai ishte vendosur nga shtatori i vitit 1943, i dalë nga Asambleja Kombëtare, në të cilën pasi ishte shpallur ndarja e Shqipërisë nga Italia, ishte caktuar Këshilli i Lartë i Regjencës me Mehdi Frashërin në krye, që më 5 nëntor kishte emëruar edhe qeverinë shqiptare me kryetar Rexhep Mitrovicën. Në spektrin politik të vendit përfshiheshin forca të ndryshme, të shfaqura gjatë kohës së regjimit të qeverisë së Mustafa Krujës, por aktiviteti i tyre ishte intensifikuar në prag të kapitullimit fashist, në verën e vitit 1943, ku më i fuqishmi shfaqej “Balli Kombëtar”, i ndjekur edhe nga “Legaliteti”.

Meqë ballistët si forca më e përhapur dhe më e konsoliduar politike në Kosovë dhe pjesët e Maqedonisë që luftonin për një Shqipëri Etnike, ishin futur në qeverinë e Rexhep Mitrovicës, ishte e natyrshme që ata, si forcë kryesore politike që kishte qeverisur vendin për më shumë se një vit, ta merrnin përgjegjësinë kryesore të mbrojtjes së vendit.

Mund të thuhet se në kuadër të kësaj përgjegjësie Ballistët, të cilët ishin forcakryesore në xhandarmëri, bashkë me njësitë e tjera mbrojtëse që i drejtonte Lidhja II e Prizrenit (numri i të cilave vlerësohej se kalonte dhjetë mijë dhe nga pikë-pamja e organizimit ushtarak dhe pajisjes mbikëqyreshin nga Vermahti), nga fi-llimi ishin vënë në ballë të detyrës, në mbrojtje të kufijve veriorë të vendit (në drejtim të Saxhakut dhe në lindje, në drejtim të Serbisë), duke u ndeshur me

for-cat çetnike të Drazha Mihajloviqit, i cili synonte që të depërtonte në pjesët verio-re të Kosovës. Ngjashëm kishin vepruar edhe në Maqedoninë Perëndimore, kur, pak më vonë, pas kapitullimit të forcave bullgare kishin pushtuar hapësirën që ata mbanin (në Shkup dhe Dibër), duke zgjeruar kështu hapësirën e shtetit shqiptar në ato pjesë për të cilat pretendonin edhe partizanët jugosllavë dhe ata shqiptarë, me të cilët ata do të zhvillojnë luftime të ashpra gjatë gjithë kohës, sidomos në pjesën e Dibrës me rrethinë, ku “gërshetoheshin” ndikimet e komunistëve maqedon-jugosllavë me ata shqiptarë mbi platformën e internacionalizmit proletar, që në të vërtetë shfaqej si karrem i ripushtimit sllavo-maqedon të asaj pjese, siç do të ndodhë në të vërtetë.

Luftimet e para me çetnikët serbë u bënë nga fundi i nëntorit të vitit 1943 me rastin e sulmit të tyre disa katundeve të Pejës dhe tutje Rugovës. Luftimet, që shkuan deri në Kollashin, zgjatën mbi tri javë, që ndonëse me humbje të shumta për të dy palët, përfunduan me disfatën e çetnikëve.<sup>1802</sup>

Në janar të vitit 1944 çeta e Pavle Gjurishiçit bëri një sulm të papritur në Morinë të Malit të Zi dhe në Çakorr, por u zbraps me humbje të ndjeshme nga forcat e Lidhjes. Po në atë kohë, pati sulme çetnike dhe në Shekullarë, ku forcat shqiptare kaluan në kundërsulm dhe pushtuan Shekullarën.<sup>1803</sup>

Sulmet çetnike shpërthyen edhe në anën e Tutinit dhe të Pazarit të Ri. Ato u thyen nga mbrojtësit nën drejtimin e Aqif Blytës, të cilit i erdhën në ndihmë vullnetarët e Ukë Sadik Gjurgjevikut, i vëllai i të cilit, Sadiku, me forcat e tij mbronte kufirin në drejtim të Kollashinit.<sup>1804</sup>

Forcat e Lidhjes së Dytë të Prizrenit, edhe pse nuk kishin shumë kohë për t’u konsoliduar ushtarakisht, kishin përgjegjësinë e mbrojtjes së kufirit në verilindje në një gjatësi nga Sanxhaku e deri në Karadak, fillimisht kundër forcave çetnike e më vonë kundër atyre partizane, të cilat u intensifikuan në verën dhe vjeshtën e vitit 1944 pasi që ushtria sovjetike të ketë depërtuar në Bullgari dhe po bëhej gati të kalonte edhe në pjesën e Jugosllavisë. Ndërkohë edhe ushtria gjermane “F” kishte filluar tërheqjen nga jugu (nga Greqia, Shqipëria dhe Serbia) drejt veriut, në përpjekjet që të shpërthente linjën e frontin të aleatëve, që kishte filluar të vendosej në Srem për ta penguar grupimin e tyre në hapësirën Danub-Elbë, prej nga Gjermanët planifikonin “stabilizimin dhe rikthimin” në luftë kundër Sovjetikëve dhe forcave aleate në pjesën qendrore të Europës dhe hapësirën gjermane.

---

<sup>1802</sup> Shih Zajmi, Tahir: “Lidhja e II e Prizrenit”, Bruksel 1964, faqe 52.

<sup>1803</sup> Po aty, faqe 52.

<sup>1804</sup> Po aty, faqe 53.

Në përputhje me këto zhvillime, edhe forcat kryesore të ushtrisë shqiptare, ato të regjimentit IV të Prishtinës të komanduara nga kolonel Fuat Dibra (Fuat Xhaferraj),<sup>1805</sup> ishin përqendruar në pjesën e kufirit nga Mitrovica deri te Gjilani dhe Karadaku, të cilat do të ndeshen me brigadat partizane jugosllave nga fundi i verës së vitit 1944 dhe gjatë vjeshtës dhe dimrit të atij viti. Në fillim të shtatorit forcat shqiptare të Regjimentit IV të Prishtinës, patën një përlëshje të ashpër në pjesët e skajshme të Podujevës me partizanët jugosllavë dhe disa njësi bullgare të konvertuara në partizanë, të cilat përpiqeshin të depërtonin në Podujevë. Me këtë rast u shkatërruan tri divizione bullare të motorizuara, që tashmë udhëhiqeshin nga komunistët. Në këto luftime mori pjesë edhe batalioni i të rinjve nga Vuçitërna “Hasan Prishtina”, i cili pati humbje të mëdha.<sup>1806</sup>

Forcat mbrojtëse të Lidhjes bashkë me ato të tjerat patriotike (të shumtën vullnetarë), gjatë gjithë muajit shtator, përkundër humbjeve të mëdha, ndalën depërtimin e aradheve partizaneve jugosllave, që sulmonin Kosovën nga verilindja dhe jugu. Por, forcat e Lidhjes, nuk ishin në gjendje t’u bënin ballë sulmeve të vazhdueshme, meqë ishin më të paktë, të papërgatitur si duhet ushtarakisht, dhe ç’ ishte edhe më keq, pas fillimit të tërheqjes së forcave gjermane drejt veriut, me anatemën e “bashkëpunëtorëve fashistë” dhe të “kuislingëve,” në Kosovë dhe Shqipëri, forca nacionaliste dhe patriotike, kishin mbetur pa furnizim dhe të vetmuara, gjë që, të përballuara me formacione të rregullta ushtarake jugosllave, të cilat ndihmoheshin nga partizanët sovjetikë, forcat e shkapërderdhura patriotike, humbjen e përbashkët e kishin të pashmangshme.

Edhe si të tilla, pra të shkëputura dhe në atë gjendje, forcat nacionaliste dhe patriotike, në luftë kundër pushtuesve sllavo-komunistë, ushqeheshin nga një nacionalizëm i sinqertë burimor-popullor, që lidhej me mbrojtjen e pragut të shtëpisë dhe të vatanit. Te disa grupe dhe formacione të shkapërderdhura ushtarake (të Ballit, Legalitetit, Lidhjes e të tjera) mbretëronte shpresa se rezistenca edhe si e tillë ja vliente të vazhdohej deri në pikën e fundit, ngaqë edhe si e tillë, do të përfillej nga aleatët anglo-amerikanë, të cilët përkundër marrëveshje që kishin me

---

<sup>1805</sup> Fuat Dibra u lind në Dibër të Madhe në vitin 1895. Pasi mbaroi kursin e oficerëve në Tiranë, shërbeu në Ushtrinë shqiptare. Gjatë Luftës së Dytë Botërore shërbeu si oficer në shumë rajone të vendit, ndërsa në fillim të vitit 1944, u caktua komandant i Regjimentit IV të sektorit “Kosova” me seli në Prishtinë. Me këtë detyrë mori pjesë në luftimet për mbrojtjen e trojeve etnike nga formacionet çetnike e partizanët serbë e bullgarë. Më 14 nëntor 1944, u dorëzua bashkë me Shtabin e Regjimentit dhe u shoqërua nga forca e Brigadës V të UNÇ të Shqipërisë për në Tiranë ku u arrestua dhe iu dorëzua autoriteteve jugosllave. U dënua me vdekje dhe u ekzekutua në Prizren, më 9 tetor 1946. (Shih: Grainca, Ibrahim-Cërnilla “Deri në vdekje për atdhe”, Prishtinë 2008, faqe 32).

<sup>1806</sup> Po aty, faqe 54.

Sovjetikët rreth ndarjeve të sferave të interesit lindje-perëndim, rezistencën shqiptare mund ta shfrytëzonin në dobi të zgjerimit të sferës së tyre.

Si do të shihet, ky iluzion do ta mbajë të gjallë rezistencën e disa grupeve të shkëputur edhe për dy vitet e ardhshme. Me të ata edhe do të largohen për në Greqi me shpresën se një ditë do të kthehen në atdheun e tyre të lirë.

Por, me fillimin e fundit të Gjermanëve në Shqipëri, erdhi edhe fundi i Qeverisë Shqiptare, e cila para një viti pati edhe miratimin e Vermahtit gjerman dhe madje edhe të vetë Hitlerit, i cili në Berlin priti Xhafer Devën, në cilësinë e Kryetarit të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, me ç'rast u morën vesh edhe për "aftësimin ushtarak të Kosovës dhe të viseve shqiptare në Maqedoni për t'u vetëmbrojtur", gjë që në të edhe filloi të punohet. Por, ishte koha tepër e shkurtë si dhe fatet e luftës që po shkonin në dëm të Fuqive të Boshtit, që pas pak atë do ta ballafaqojnë me disfatën, që e pamundësuan të ngrihet në nivel të përgjegjësisë së duhur.<sup>1807</sup>

Në këto rrethana, ishte e natyrshme që edhe qeveria e Rexhep Mitrovicës dhe së fundit ajo e Xhafer Devës, me hapësirë të kufizuar veprimi dhe të varur nga raportet e luftës botërore, të përjetonin fatin e mbështetësve të tyre kryesorë. Kështu, çastet që Gjermanët përgatiteshin të largohen nga Shqipëria, më 26 tetor, Qeveria Shqiptare shpallni botërisht fundin e çdo veprimtarie dhe, me ndihmën e Gjermanëve, nga ana e detit, u larguan në drejtim të Vjenës dhe Berlinit.<sup>1808</sup>

Largimi i qeverisë së Xhafer Devës dhe udhëheqjes së ngushtë të saj në drejtim të Perëndimit i hapi rrugë triumfit partizan si dhe vendosjes së pushtetit të tyre.

Në Kosovë, vendosja e pushtetit partizan njëherësh do të thoshte ripushtim i Kosovës nga sllavo-komunistët, që për uverturë pati futjen e njësisve partizane nga Shqipëria (Brigada V dhe III), të cilat pas pak atë do t'ua dorëzojnë partizanëve jugosllavë. Brigadat e tyre (të shumtën çetnikë të konvertuar në partizanë), me mbi 30 mijë forca të organizuara ushtarake, depërtuan nga drejtimi i Poduje-

---

<sup>1807</sup>Sa i përket rolit mbrojtës së vendit nga pushtuesit sllavo-komunistë, nga pikëpamja organizative, Lidhja e Dytë e Prizrenit, shfaqet thajse analoge me strukturat e Lidhjes së Parë të vitit 1878. Kryetar i parë i Komitetit Qendror të Lidhjes Rexhep Mitrovica, që njëherësh ishte edhe kryeministër i Qeverisë shqiptare të Tiranës, kishte edhe përgjegjësinë e forcave mbrojtëse të Lidhjes, të cilën nuk ishte në gjendje ta kryejë. Pas tij këtë detyrë e mori Bedri Pejani dhe së fundi Xhafer Deva. Me ardhjen e Bedri Pejani për kryetar do të shtrohet edhe çështja e formimit të njësisve të rregullta ushtarake të Lidhjes, të cilat do t'i nënshtroheshin komandës së saj. Lidhja e Dytë e Prizrenit do të vendosë që të formojë degët e veta dhe të ruajë prerogativat e komandës qendrore ushtarake, e cila do të udhëhiqte luftën kundër partizanëve si dhe mbrojtjen në të gjitha rrethanat nga depërtimet jugosllave dhe greke dhe sulmeve të tjera nga jashtë. Bedri Pejani më 29 mars 1944 i dërgoi një letër Hitlerit, ku e njoftonte për Lidhjen si dhe qëndrimin e saj për formimin e një divizioni SS në Kosovë bashkë me një forcë ushtarake prej rreth 120 mijë ushtarësh që do të ishte në gjendje të mbronte Kosovën. Me këtë rast do të kërkojë mjete dhe ndihmë për arritjen e këtij qëllimi. (Më gjerësisht shih: Zajmi Tahir: "Lidhja e II e Prizrenit", Bruksel 1964).

<sup>1808</sup>Po aty.

vës, Shkupit dhe pas pak edhe nga Çakorri, në drejtim të Pejës, duke ripushtuar pëllëmbë për pëllëmbë hapësirën e saj.

Sidoqoftë, edhe në atë gjendje të rëndë të okupimit të Kosovës nga ana e forcave partizane jugosllave, që ua kishin hapur rrugën partizanët e Shqipërisë, hyri në jetë betimi i mbrojtjes së vatanit në formën e shprehjes së rezistencës së armatosur, e cila ndonëse nuk do të ketë një koncept gjithëpërfshirës dhe as një qendër të përbashkët veprimi, megjithatë riaktivizoi gjuhën e mospajtimit me pushtimin sllavo-komunist, e cila u pasqyrua me shfaqjen e rezistencës së armatosur ndaj një gjenocid tashmë të paralajmëruar që vendit po i përgatitej nga komunistët. Ai bëhej edhe më ogurzi kur lidhej me programet e kahershme hegjemoniste të Beogradit ndaj Shqiptarëve dhe hapësirës së tyre jetësore, të cilave rrethanat e reja ua krijonin këtë mundësi.

Edhe pse propaganda jugosllave menjëherë rezistencën e forcave të shkapërdhura balliste dhe të grupimeve të tjera nacionaliste dhe patriotike kundër ripushtimit sllavo-komunist të Kosovës (fillimisht në Ferizaj dhe pastaj në Gjilan, e cila do të jetë më e theksuar nga fillimi i dhjetorit), ku në shumë prej tyre edhe më tutje kishte flakëruar shpresa e zbarkimit të premtuar anglo-amerikan, do ta cilësojë “fillim i kundërrevolucionit shqiptar të përmasave të mëdha”, që udhëhiqej drejtpërdrejt nga “shtabi i fshehur i Xhafer Devës”<sup>1809</sup> e të ngjashme - ajo nuk kishte qenë e tillë dhe as që kishte pasur mundësi të ishte e tillë. Meqë në Kosovë nuk kishte ngadhënjyer kurrfarë revolucioni, siç quhej, por kishte ndodhur ripushtimi i saj nga aradhet partizane jugosllave, të cilat kishin rrënuar një pushtet legjitim shqiptar, të shpallur në tetorin e vitit 1943 nga përfaqësuesit e vet legjitim, të zgjedhur në mënyrë demokratike.

Fakti se shteti i pavarur shqiptar kishte lindur në rrethanat e pushtimit gjerman që kishte zëvendësuar atë italian dhe si i tillë ishte pranuar prej tij madje duke iu garantuar edhe neutraliteti dhe se forcat nacionaliste shqiptare në Kosovë dhe gjetiu ishin vënë në mbrojtje të tij dhe kundër ripushtimit jugosllav, ata nuk mund t’i kthente në “kuislingë” dhe “shërbëtorë të okupatorit” me të cilët duhej qëruar hesapet me mjete revolucionare pasi që të jenë shpallur “kundërrevolucionarë”, por në viktima të një terrori të ri shtetëror-ideologjik, që po vendosej për të lansuar një diktaturë të re komuniste.

Andaj, nga kjo pikëpamje, rezistenca e armatosur shqiptare në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore kundër ripushtimit të saj nga partizanët jugosllavë

---

<sup>1809</sup> Shih Djaković, S: *”Sukobi na Kosovu”*, 1984, faqe 236.

dhe aleatët e tyre shqiptarë, njëherësh paraqiste rezistencën e parë të armatosur antikomuniste në Europë në vigjilje të fitores së komunizmit në lindje të saj dhe të lansimit të socializmit si model shtetëror në përputhje me ideologjinë e bolshevizmit sovjetik.

Lëvizja antikomuniste shqiptare, e fokusuar të shumtën në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore, mbeti “e shkëputur”, e papërkrahur dhe me anatemën “e kundërrevolucionit” që ia vunë jugosllavët, ngaqë, si u pa në Konferencën e Jaltës, anglo-amerikanët nuk ishin në gjendje për një konfrontim me Sovjetikët - aleatin e tyre të fuqishëm kundër fashizmit.

Në këto rrethana, alarmi i shpërthimit të “kundërrevolucionit”, i shpallur me të gjitha kambanat, jugosllavëve u shkoi për shtati që atë ta shfrytëzojnë shumanshëm për t’i realizuar qëllimet sa më parë, dhe kjo ishte në përputhje me qortimet dhe kërcënimet që i vinin Kosovës që nga Konferenca e Bujanit, sipas të cilave hyrja në Kosovë e njërive partizane jugosllave duhej të sillte:

a) rrënimin e strukturave të pushtetit vendor, të dala nga Konferenca Nacional-çlirimtare e Bujanit

b) rrënimin e strukturave ushtarake të Shqiptarëve si dhe shkrirjen e mbetjeve të tyre në përbërje të ushtrisë jugosllave

c) anulimin e vendimeve të Bujanit rreth vetëvendosjes së Shqiptarëve për t’u bashkuar me Shqipërinë si të drejtë që u takonte në përputhje me Kartën e Atlantikut dhe krahas kësaj të krijohen rrethanat për një “deklarim tjetër vullnetar” të bashkimit të Kosovës me Serbinë nga i njëjti forum si dhe

d) fillimin e qërimit të hesapeve me nacionalistët shqiptarë dhe patriotët, këtë herë në emër të “bashkëpunëtorëve të fashizmit”, me çka mund të hiqej qafe secili shqiptar që nuk i përkiste lëvizjes nacionalçlirimtare të udhëhequr nga komunistët.

Kështu, pa dimensionin e “kundërrevolucionit” dhe alarmin e tij, Jugosllavët nuk do të mund të shpallnin vendosjen e gjendjes ushtarake, më 8 shkurt 1945, dhe pa këtë “alarm”, nuk do të mund të krijonin rrethanat për ripushtimin faktik të Kosovës dhe aneksimin e saj nga Serbia, duke përfshirë këtu Kuvendin e Prizrenit mbajtur nga 8-10 korrik 1945, edhe pse për këtë ata kishin miratimin e Konferencës së Jaltës.

Hipoteka e kundërrevolucionit, krahas Kosovës, duhej të vepronte ngjashëm edhe në Maqedoni, veçmas kundër pjesës perëndimore, në mënyrë që edhe atje të jetësohej projekti i Maqedonisë së ASNOM-it të cilën Titoja e kishte themeluar në gusht të vitit 1944, duke e kyçur atë në planin e federatës së ardhshme në përputhje me vendimet e AVNOJ-it të vitit 1943.

Edhe pse realitetet në Maqedoni shfaqeshin tjera pas kapitullimit të bullgarëve dhe të tërheqjes së gjermanëve, me ç'rast vendin e tyre do ta zënë më të shpejtë forcat e përbashkëta partizane jugosllave, maqedonase, sovjetike dhe së fundi edhe ato shqiptare, megjithatë, mbetej si prioritet “qërimi i hesapeve me ballistët shqiptarë dhe kuislingët tjerë”, të cilët kishin mbështetje të madhe në pjesët perëndimore, ku për afër katër vjet, shteti shqiptar (ai nën italianët dhe i vendosur nga gjermanët në fund të vitit 1943 e deri në tetor 1944), kishte ushtruar pushtet.

### MEMORANDUMI I DYTË I ÇUBRILLOVIQIT DHE VAZHDIMI I POLITIKËS ANTISHQIPTARE

Se ripushtimi jugosllav me anën e partizanëve në Kosovë dhe pjesët tjera shqiptare në Maqedoni do të merrte këtë kahe, që pas katër muajsh të arrijë edhe përmasat e një gjenocidi, të tretit me radhë (i pari në dimrin e vitit 1877/8 me rastin e depërtimit serb në Prokupe e Kurshumli, i dyti në vitin 1912, me rastin e pushtimit të Kosovës dhe të viseve të tjera serbe nga ushtria serbe), këtë e paralajmëronte Memorandumi i dytë i Vasa Çubrilloviqit, autorit të Memorandumit të parë antishqiptar të akademikëve serbë nga vitit 1937, i cili, në tetor i ishte dorëzuar Titos, por tash si një elaborat me shifrën e punës: “*Problemi i pakicave në Jugosllavinë e re*”. Theksi ishte vënë tek qërimi përfundimtar i hesapeve me “folksdojçerat” (popullatën autoktone gjermane në Banat dhe Srem në Veri, që kapte rreth 700 mijë vetë). Ata duhej dëbuar nga trojet e tyre me anatemen e kolaboracionistëve të fashistëve gjermanë dhe si të tillë duhej të ndiqeshin pamëshirshëm.

Elaborati, po ashtu parashihte që në Kosovë dhe në viset shqiptare në Maqedoni - ku po sipas Çubrilloviqit kishte pasur një qeveri kuislinge që udhëhiqej nga irredenta kosovare në krye me Xhafer Devën, të cilësuar si top-agjent gjerman - duhej të shpallej “shpërthimi i kundërrevolucionit”, sapo Shqiptarët të reagonin ndaj provokimeve të ndryshme, të cilat duhej t’i sillnin ata patjetër buzë shpërthimit.

“Për ne, problemi kryesor është si t’i shkatërrojmë blloqet e pakicave në territoret e rëndësishme gjeopolitike” për të theksuar: se “shteti është ai i cili me të gjitha mjetet dhe mënyrat duhet këtë ta ndihmojë”<sup>1810</sup>.

---

<sup>1810</sup> Shih Memorandumi i dytë i Vasa Çubrilloviqit: “*Problemi i pakicave në Jugosllavinë e re*”, i nëntorit 1944, dorëzuar mareshalit Tito, botuar në “Mladina” të Lubjanës, 1990.

Ndër këto mënyra, si më të përshtatshmen për rrethanat, ai do ta përmendë luftën, me të cilën mund të zgjidhet ky problem jetik.

*“Ushtria gjatë operacioneve të luftës duhet të spastrojë në mënyrë të planifikuar e pa mëshirë pakicat kombëtare...”*<sup>1811</sup>

Krahas pastrimit të Kosovës nga Shqiptarët, Çubrilloviqi kërkonte edhe pastrimin e Pollogut të Maqedonisë, prej tyre dhe të viseve të tjera shqiptare në Mal të Zi, të cilat, po ashtu kishin një rëndësi të madhe për shkatërrimin e etnisë shqiptare në Jugosllavi.

*“Kosova dhe Metohia janë konsideruar si qendra strategjike të Ballkanit. Kjo zonë e ndanë Malin e Zi nga Serbia dhe të dyja këto nga Maqedonia. Këto territore të Jugosllavisë Demokratike Federative nuk do ta kenë të fortë lidhjen reciproke midis tyre, derisa të arrijnë të kenë kufi direkt etnik. Kjo çështje është veçanërisht e rëndësishme për Maqedoninë. Territorin e rrjedhës së Vardarit të Sipërm e kanë Shqiptarët, kurse rrjedhën e tij të poshtme e kanë grekët. Ne sllavët e jugut kemi vetëm rrjedhën e tij të mesme. Pozicionet tona, nga kjo pikëpamje, janë tepër të dobëta... Për ne janë të rëndësishme ekonomikisht fushat pjellore të Pollogut, Kosovës dhe Metohisë...”*<sup>1812</sup>

Që elaborati të ketë sukses, Çubrilloviqi kërkoi postin e ministrit të agrarit në qeverinë federative me premtimin se *“me gjithë zemër do të vë në dispozicion të gjitha dijet dhe përvojën, në shërbim të Komandës së Lartë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe të njërive partizane për hartimin e planeve të hollësishëm”*.<sup>1813</sup>

Tito pranoi ofertën e Çubrilloviqit, sado që asnjëherë nuk u pranua se mandati i tij në këtë post lidhej me farë elaborati për qërimin e hesapeve me pakicën gjermane dhe me Shqiptarët në rrethanat e luftës. U tha se historiani serb në kabinetin e qeverisë së parë federative kishte gjetur vend në saje të propozimit të Serbisë.<sup>1814</sup>

Pa marrë parasysh arsyetimet, si dhe pse historiani i njohur, atentatori i Sarajevës ndaj princit Ferdinand, në vend të resorit të kulturës apo të shkencës, ta marrë atë të agrarit, ai do ta ketë në dispozicion gjithë infrastrukturën e nevojshme ushtarake dhe policore për të arritur qëllimet e parashtruara. Dhe si do të shihet, ofensiva e Sremit e dhjetorit 1944 dhe e janar – prillit 1945, do të përfundojë me sukses të plotë dhe në përputhje me programin e Çubrilloviqit. Atë që nuk do ta

---

<sup>1811</sup> Po aty.

<sup>1812</sup> Po aty.

<sup>1813</sup> Po aty.

<sup>1814</sup> Nga biseda e autorit me Fadil Hoxhën, në Prishtinë më 1994.



bëjnë kaçushat sovjetike në këtë front, do ta bëjnë njësitet çetnike të konvertuara në partizanë sipas marrëveshjes së njohur Tito-Shubashiq e arritur me ndihmën e Anglezëve. Partizanët pastruan nga popullata autoktone gjermane një nga një vendbanimet gjermane në Sllavoni dhe Banat me arsyetimin se kishin qenë shërbëtorë të gjermanëve.

Dyqind mijë Gjermanë të vrarë pamëshirshëm qëllimisht të ngjuar nëpër vijat e fronteve dhe gjashtëqind mijë të tjerë të përzënë nga trojet, të detyruar të shpërngulen përgjithmonë në Gjermani, është bilanci “brilant” i Elaboratit të Çubrilloviqit nga nëntori 1944. Në këtë gjenocid morën pjesë ushtarakisht edhe forcat aleate (sovjetike), të cilat bartën barrën kryesore në frontin e Sremit.

Në përputhje me këtë elaborat do të veprohet edhe në Kosovë dhe në viset shqiptare në Maqedoni, të cilat, gjatë luftës, ishin në përbërje të shtetit të përbashkët shqiptar. Meqë aty nuk ishte linja e përballjes me Gjermanët si në Srem, por ajo me forcat patriotike shqiptare që mbroheshin nga ripushtimi sllavo-komunist, e cila nga pikëpamja ushtarake nuk kishte gjasa që të kthehej në një front që do të zgjaste, e gjitha duhej të kishte pretekst “shpërthimin e kundërrevolucionit“. Kjo do ta arsyetonte fushatën ushtarake “për pastrimin e vendit nga bashkëpunëtorët e fashizmit”, si dhe vendosjen e administratës ushtarake si mjet të saj.

Edhe pse nuk do t’ia dalë që Kosovën dhe Maqedoninë Perëndimore dhe veç-mas Shkupin me rrethinë si një e rëndësishme që lidhte etninë shqiptare historikisht dhe politikisht, ta spastrojë nga Shqiptarët siç kërkonte Çubrilloviqi, megjithatë për gjashtë muaj sa zgjati gjendja ushtarake për pasojë do të ketë vrasjen e mbi pesëdhjetë mijë Shqiptarëve në forma të ndryshme. Ky kalvar do të ndodh nëpër frontet anembanë Kosovës dhe Maqedonisë, deportimet e ndryshme të di-sa mijëra të të mobilizuarve me dhunë, që po ashtu me dhunë, do të dërgohen nëpër frontet e vdekjes në Srem dhe përgjatë Adriatikut, e deri te likuidimet e fshehta, të cilat do të marrin përmasat e kryerjes së një gjenocidi!

Krahas viktimave, më pasoja të rënda për popullatën shqiptare do të jetë terrori komunist, i vendosur nën maskën e pushtetit popullor dhe të vëllazërim-bashkimit, i cili, me vendimet e AVNOJ-it, ata i kishte shkëputur në dy pjesë: nën pushtetin e Serbisë federative (Kosova) dhe në kuadër të Republikës së Maqedonisë(Shkupin me Maqedoninë Perëndimore). Kjo shkëputje ishte shfaqur edhe gjatë luftës, me organizimin komunist (komitetet krahinore të Kosovës dhe Metohisë dhe të Maqedonisë të lidhura me KQ të PKJ-së) dhe në kuadër të lëvizjes nacionalçlirimtare (po ashtu, si të ndara të lidhura me atë KANÇJ-së), të drejtuara

nga i deleguari i Titos për Kosovë, Maqedoni dhe Shqipëri, Svetozar Vukmanoviq- Tempo.

Dhe, si masë e parë e gjithë asaj që do të kthehet në një tragjedi të përmasave të një gjenocidi ndaj një populli të pambrojtur, shfaqej mobilizimi i dhunshëm i rreth njëzet mijë të rinjve shqiptarë dhe dërgimi i tyre në frontin e Sremit dhe në atë të Adriatikut, ku pjesa më e madhe e tyre nuk do të kthehen më.

I gjithë ky kalvar gjaku ndaj popullit shqiptar dhe qenies së tij, do të fillojë në Maqedoni në dhjetor 1944 me mbledhjen e jashtëzakonshëm të ASNOM-it në Shkup, në të cilën morën pjesë udhëheqësit më të lartë komunistë jugosllavë, ndër ta Eduard Kardel, Kolishevski e të tjerë, me ç'rast dora e djathtë e Titos, shpalosi platformën kundër “bashkëpunëtorëve të fashizmit dhe forcave kuislinge” si dhe “domosdosë që me ta të qërohen hesapet me të gjitha mjetet”<sup>1815</sup>, dhe, në Kosovë, me direktivën që Milladin Popoviqi, i kthyer nga Shqipëria, në emër të Komitetit Krahinor të Partisë Komuniste të Jugosllavisë për Kosovë dhe Metohi (emërtimi Dukagjin do të zëvendësohet me atë Metohi njëanshëm si reaksion ndaj, si thuhej, “shqiptarizimit” të bazës partiake të Kosovës në dëm të përkatësisë jugosllave). Kështu, në Maqedoni, dekretet ushtarake nga ASNOM-i “për luftë kundër bashkëpunëtorëve të okupatorit fashist dhe forcave kuislinge” dhe ato në Kosovë, të Milladin Poppviqui, për “luftë kundër reaksionit dhe forcave armiqësore”, do t’u drejtohen të gjitha komiteteve vendore partiake, u kthyen në armë të pushtetit revolucionar me kompetenca të mëdha, në të cilat kërkohet:

- 1) mobilizimi i të rinjve shqiptarë dhe dërgimi në frontet e Veriut,
- 2) pastrimi i terrenit nga armiqtë klasorë, pra me ata që i kishin shërbyer okupatorit dhe tradhtarëve të vendit,
- 3) që të mblidheshin armët nga popullata shqiptare,
- 4) që të rreñoheshin të gjitha format e organizimit të mëparshëm të pushtetit vendor (Këshillat Nacionalçlirimtare) të vendosura jashtë kritereve të PKJ-së, pra ato që ishin themeluar gjatë LNÇ-së (Këshillat antifashist si formë e pushtetit vendor) dhe

5) që nëpër katundet me popullsi shqiptare të themelohen organizatat partiake, ato të rinisë, sportive dhe të tjera sipas “kritereve” të vëllazërim-bashkimit.<sup>1816</sup>

Fillimi i zbatimit të këtyre masave si dhe fushata e egër e qërimit të hesapeve me intelektualët shqiptarë, forcat patriotike nga radhët e parive të deriatëhershme

---

<sup>1815</sup>Pirjevac, Jože: „Tito i drugovi“, Zagreb, 2012, faqe 386-390.

<sup>1816</sup>Shih Djaković, S: „Sukobi na Kosovu“, 1984, faqe 236.

të qyteteve dhe të katundeve si dhe tërbimi shovinist i njësive çetnike serbe të konvertuara në ato partizane ndaj çdo gjëje shqiptare, pati për pasojë rezistencën popullore. Si e tillë, ajo u shfaq, së pari ndaj marrjes së pushtetit të njësive okupuese partizane jugosllave nga partizanët shqiptarë, të cilëve popullata e Kosovës dhe ajo e Maqedonisë, me rastin e depërtimit, nuk ua kishte kthyer pushkën ngaqë kishin hyrë me premtimin se ruhej pushteti shqiptar. Rezistenca më e theksuar pastaj do të shprehet ndaj mobilizimit të dhunshëm dhe dërgimit të Shqiptarëve në frontet e luftës në veri dhe nëpërmes Shqipërisë, nëpër Mal të Zi drejt Adriatikut për t'i arritur përmasat e një kryengritjeje të përmasave kombëtare.

### “LËVIZJA NACIONAL DEMOKRATIKE” (NDSH) E SHKUPIT DHE BASHKIMI SHQIPTAR

Lëvizja Nacional Demokratike Shqiptare (NDSH), lindi në rrethanat dramatike, ato të viteve 1945-1947, nëpër të cilat po kalonte bota shqiptare në prag të përfundimit të luftës antifashiste, me ç’rast ajo u ballafaqua me sfidat ekzistenciale, të cilat i vinin në njërën anë nga raporti i forcave të luftës, ku e majta dilte fituese dhe me këtë përcaktonte edhe sistemin shoqëror mbi baza ideologjike, dhe në tjetrën nga sferat e interesit të fuqive të mëdha, me të cilat Jugosllavia si shtet ruante integritetin territorial të para shkatërrimit, gjë që edhe realitetin shoqëror dhe politik shqiptar të viteve të përbashkëta (1941-1945), e kthente në gjendjen e ndarjes që ia kishte përcaktuar Konferenca e Londrës dhe konfirmuar ajo e Paqes në Paris.

Në këto rrethana bota shqiptare ndodhej dyfish e hendikepuar: e ndarë në dy shtete, ndërsa e bashkuar ideologjikisht në sferën lindore. Kjo e dyta e kthente në kthetrat e pushtetit sllavo-komunist të drejtuar nga shteti komunist sovjetik me pasoja të rënda dhe të paparashikuara, që sapo hyri në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare që për disa vite kishin jetuar në rrethanat e një bashkimi, ripushtimin e lidhi me terrorin shtetëror me anën e të cilit filloi qërimi i hesapeve me inteligjencën shqiptare, patriotët si dhe forcat tjera, që luftonin për një ardhmëri të përbashkët, demokratike dhe perëndimore. Ishte kjo një luftë me të cilën synohej rrënimi i gjithëmbarshtëm i vetëdijes historike të Shqiptarëve si popull i lashtë, që i kishte takuar qytetërimin perëndimor dhe hapësirës së tij.

Duke mos u pajtuar me këtë gjendje me të cilën atyre u rrënohej qenia si popull dhe qytetërim, forcat nacionaliste shqiptare, të cilat kishin qenë të lidhura

me shtetin e bashkuar shqiptar, pa marrë parasysh se në çfarë rrethanash ishte krijuar ai, duke e konsideruar atë si të drejtë që u takonte kurdoherë për të cilën duhej luftuar pareshtur, iu kishin kundërvënë ripushtimit partizan të Kosovës dhe të viseve shqiptare në Maqedoni, e me këtë edhe vendosjes së komunizmit qysh në çastet e para të largimit të ushtrisë gjermane dhe paralajmërimit të futjes së forcave partizane shqiptare dhe jugosllave ngaqë e dinin fare mirë se çfarë po i përgatitej atyre dhe Shqipërisë, veçmas pas prishjes së Marrëveshjeve të Mukjes nga ana e komunistëve shqiptarë të drejtuar nga ata jugosllavë.

Ushtria shqiptare dhe forcat e tjera patriotike deri më atëherë në kuadër të Forcave të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, të cilat vëmendjen kryesore e kishin përqendruar në mbrojtjen e vendit nga pushtimet sllavo-komuniste, ndonëse të shkapërderdhura, kishin bërë luftimet e para me partizanët jugosllavë që depërtonin nga verilindja (Presheva dhe Karadaku) dhe juglindja (Maqedonia). Ngjashëm ishte vepruar edhe në Pollogun e Maqedonisë (nga Shkupi, Kërçova e deri në Dibër), kur forcat nacionaliste kishin rikthyer hapësirën që deri më atëherë e mbanin të pushtuar forcat bullgare, të cilat, kishin vazhduar me terrorin kundër popullatës shqiptare.

Në të vërtetë, lufta patriotike, që do të zgjasë për mbi një muaj, filloi në tetor 1944, pasi që ushtria fashiste bullgar të ketë kapitulluar, vendin e tyre zunë ato të njëjstëve të major Xhemë Gostivarit.<sup>1817</sup>

Xhemë Gostivari depërtoi me forcat patriotike në rajonin e Shkupit dhe të Kumanovës, të cilat iu bashkëngjitën Shqipërisë etnike. Në Shkup, KQ i Lidhjes II të Prizrenit, emëron prefekt të prefekturës, Esat Berishën. Bashkë me Esat Berishën, në Shkup arriti edhe një grup ushtarakësh, të udhëhequr nga QazimLusha, Mehmet Bushi, Arif Drogomanci, Memish Bukoviqi dhe AbdylDurra, të cilët, në bashkëpunim me udhëheqësit vendor, krijuan shtabin luftarak të prefekturës së Shkupit, në kuadër të së cilës vepronin tre batalione.

Batalioni i Treskës, me komandant Memish Bukoviqin kishte 2500 ushtarë. Batalioni i Bllacës, me 1500 luftëtarë, komandohej nga Adyl Durra dhe batalioni i Kopilaçës me 1000 luftëtarë, me komandant Din Hoxhën. Në rajonin e Karadakut të Kumanovës vepronte batalioni i Karadakut, me komandant Sylë Hotla, dhe ishte i lidhur me prefekturën e Gjilanit.<sup>1818</sup>

Në kuadër të aktiviteteve për mbrojtjen e trojeve etnike që tashmë gjendeshin në përbërje të shtetit shqiptar të themeluar në tetorin e vitit 1943 në Tiranë, në tetor të vitit 1944, Shkupin, Tetovën dhe Gostivarin i vizitoi Xhafer Deva,

---

<sup>1817</sup> Lita, Qerim: "KQ i NDSH-së dhe Azem Marana", Tiranë, 2011, faqe 45.

<sup>1818</sup> Po aty, faqe 46.

kryetar i Komitetit Qendror të Lidhjes II të Prizrenit. Me këtë rast u tha se forcat kombëtare do të mbrojnë deri në një shtetin etnik shqiptar, i cili, po rrezikohej nga aleanca e përbashkët sllavo-komuniste, si dhe aradhet e përbashkëta partizane në pjesën lindore.

Bashkimi i forcave kombëtare pas çlirimit të Shkupit dhe shtrirjes së pushtetit shqiptar në pjesën e Maqedonisë Perëndimore, bashkoi edhe forcat komuniste: jugosllave dhe shqiptare, të cilat operonin në periferi të hapësirës së viseve etnike të shtetit shqiptar, në pjesën që deri më dje shtrihej pushteti fashist bullgar. Meqë, partizanët jugosllavë dhe ata maqedonas në periferi të trojeve shqiptare nuk mund t'ia dilnin me forcat luftarake të Lidhjes II të Prizrenit, kërkuan ndihmë nga partizanët shqiptarë. Kështu, në Peshkopi, kreu i PKM-së Svetozar Vukmanoviq-Tempo, i dërguar i Titos për lëvizjen komuniste në Kosovë, Maqedoni dhe Shqipëri si dhe në përgjithësi për organizimin e nacionalçlirimtares sipas kutit të Beogradit, takohet me Mehmet Shehun, komandant i Divizionit I të UNÇSH. Aty u mor vendimi që në Kërçovë dhe Gostivar të dërgoheshin repartet e UNÇSH-së me flamur shqiptar, ku edhe do të vendosej pushteti i nacional-çlirimtares i zgjedhur nga shqiptarët.<sup>1819</sup>

Krahas futjes në Kërçovë dhe Gostivar me anën e karremit partizan shqiptar, që do të futej gjoja për të rikthyer “pushtetin shqiptar”, në depërtimin në Shkup morën përsipër partizanët jugosllavë. Shtabi i Përgjithshëm i UNÇM-së autorizoi Divizionin 42 me dy brigada për këto operacione luftarake, në një vijë fronti prej disa kilometrash. Luftimet filluan më 25 tetor dhe zgjatën dy ditë. Forcat shqiptare të komanduara nga Xhemë Gostivari, në betejën e Treskës, thyen thuajse në tërësi forcat partizane, të cilat mezi shpëtuan një numër të vogël luftëtarësh. Në këtu luftime u vranë mbi 380 partizanë dhe shumë të tjerë u plagosën. Humbjet e thella u pranuan edhe nga partizanët.<sup>1820</sup>

Humbje të ngjashme, në luftimet e Kërçovës, të 7-8 nëntorit 1944, pësuan edhe brigadat maqedonase nga Divizioni 42 bashkë me Brigadën IV shqiptare dhe batalionin IV të Brigadës 18 sulmuese të Shqipërisë. Me këtë rast partizanët maqedonas dhe shqiptar marrin urdhër të tërhiqen nga vendbanimet shqiptare.<sup>1821</sup>

---

<sup>1819</sup> Nasi, Lefter: “Ripushtimi i Kosovës – shator 1944 korrik 1945”, Tiranë, 1994, faqe 48.

<sup>1820</sup> ДАРМ.1.255. 6479, 37А, 30.10.1944/1-3.

<sup>1821</sup> ДАРМ.1.254. Телеграм до Втората Корпусна зона К.37/АIII,07/08.11.1944.

Luftimet u zëvendësuan nga bisedimet me disa krerë nacionalistë shqiptarë për t'i luftuar forcat gjermane në tërheqje. Me këtë rast, nacionalistëve shqiptarë u premtohet se Struga me rrethinë si dhe Dibra, do t'u takojnë Shqipërisë.<sup>1822</sup>

Krahas frontit kombëtar të Maqedonisë, ku luftohej kundër koalicionit anti-fashist jugosllavo-shqiptar, lufta mbrojtëse do të zhvillohet edhe në Anamoravë dhe Luginën e Preshevës në tetor të vitit 1944, gjithashtu me një intensitet të shtuar me forcat sllavo-komuniste dhe ato partizane nga Shqipëria, për të vazhduar edhe gjatë nëntorit dhe dhjetorit. Në rrethanat e reja të ballafaqimit me forca të mëdha partizane, forcat e mbrojtjes kombëtare, në Anamoravë shfaqen me “Shtabin Suprem”, nën drejtimin e Adem Gllavicës, i cili mori përsipër drejtimin e luftimeve në Gjilan, Ferizaj dhe pjesët e tjera të Anamoravës, në mënyrë që e gjitha në prill të vitit 1945 të kthehet në një lëvizje të gjerë të rezistencës kombëtare nën plat-formën politike të “Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare”, e cila tashmë e kishte shpallur hapur luftën për një Shqipëri të bashkuar, të lirë dhe demokratike.

Andaj, nuk ishte e rastit që ideja për një organizim të përbashkët politiko-ushtarak, që do të udhëhiqte lëvizjen e rezistencës shqiptare, të vinte njëherësh nga Shkupi dhe Anamorava, ngaqë pikërisht këtyre pjesëve, krahas ndarjes Kosovë-Shqipëri në përputhje me atë që kishte sjellë Konferenca e Londrës dhe e Parisit, e që e kishte konfirmuar ato ditë edhe Jalta, Shqiptarëve në përbërje të Jugosllavisë “së re e demokratike”, u vinte edhe një ndarje tjetër: nën Maqedoninë dhe nën Serbinë. Ndarja në republikat simotra shfaqej edhe më e rëndë, ngaqë ajo prekte themelet e etnisë shqiptare të Kosovës dhe të Maqedonisë Perëndimore, e cila nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e këndeje kishte qenë qendër shpirtërore dhe politike e Shqiptarëve në luftë për pavarësi kombëtare, ku Prizreni dhe Shkupi njësoj kishin ushqyer idetë e bashkimit shqiptar dhe të shtetësisë së tij. Në rrethanat e reja, Prizreni kthehej në qendër të një province (oblasti) nën Serbi, ndërsa Shkupi, qyteti më i madh shqiptar nga antikiteti, mesjeta dhe gjatë kohës së Perandorisë Osmane qendër e Vilajetit të Kosovës, ku edhe kishte qenë epiqendra e zhvillimeve historike (1878-1912) që kishin sjellë pavarësinë e Shqipërisë, kthehej në qendër të shtetësisë të një kombi politikisht të formuar (Maqedonas), me detyrë që ta shuante identitetin shqiptar nga aty me anën e metodave të dhunës politike dhe shtetërore (privimi nga arsimi kombëtar, heqja gjuhës shqipe në

---

<sup>1822</sup> Lita, Qerim: “*KQ i NDSH-së dhe Azem Marana*”, Tiranë, 2011, faqe 52.

administratë, stimulimi i emigrimit për në Turqi, sforcimi i turqishtes e të tjera) deri në shuarje të tyre fizike në të.

Si reagim ndaj kësaj gjendjeje, kur në Kosovë, Karadak dhe pjesët e tjera të Maqedonisë Perëndimore forcat patriotike nga radhët e Divizionit IV shqiptar dhe ato të Ballit Kombëtar po luftonin kundër njërive partizane dhe terrorit të tyre, në Shkup, i cili pas kapitullimit të forcave bullgare, për disa kohë kishte qenë në duart e nacionalistëve shqiptarë, gjatë muajit mars të vitit 1945, u shfaq “Organizata Nacional Demokratike Shqiptare”. Kjo parti politike, luftës së filluar kundër ripushtimit jugosllav dhe për bashkimit shqiptar, duhej t’i jepte një platformë të qartë politike.

Organizata u themelua në shtëpinë e Hysniqemal Ejupit, ku morën pjesë: Azem Marana, Mahmut Dumani, Hasan Bilalli, Hysniqemal Ejupi, Nebi Jonuzi dhe Nuredin Ibrahim. Sipas organizatorëve, NDSH, në rrethanat e ripushtimit sllavo-komunist të Kosovës dhe të Maqedonisë dhe ndarjes së saj midis Maqedonisë dhe Serbisë, si synim kryesor kishte bashkimin e Kosovës dhe viseve të tjera me shumicë shqiptare me Shqipërinë.<sup>1823</sup>

Që kjo të sendërtohet, NDSH dhe drejtuesit e saj u zotuan sa më shpejtë të vendosin lidhje vëllazërore me nacionalistët shqiptarë në Kosovë dhe Shqipëri, të cilët ishin të shumtë por pa një qendër drejtuese.<sup>1824</sup>

Në kuvendin themelues, po ashtu, u tha se vëmendje e veçantë do t’i kushtohet ngritjes nacionale të Shqiptarët, me çka do të zgjerohet dëshira dhe vullneti i tyre për bashkim kombëtar.<sup>1825</sup>

Themelimi i NDSH-së dhe programi i saj kombëtar nuk mbeti i pavërejtur. Nacionalistët shqiptarë, të cilët e kishin gjithnjë e më të qartë se pushteti popullor komunist po zhvillonte një veprimtari të hapur kundër Shqiptarëve dhe qenies së tyre, filluan t’i bashkohen asaj, veçmas pas copëtimit të hapësirës së tyre në shumë pjesë (Kosovë, Maqedoni, Luginë të Preshevës). Bie në sy se krahas nacionalistëve të devotshëm që nuk pajtoheshin me ripushtimin sllavo-komunist dhendarrjen që sillte ai, do të jenë ish partizanë, pastaj prefektë komunash dhe të tjerë të përfshirë në radhët e nacionalçlirimtarës, por të zhgënjyer nga mashtrimet e saj, që do t’i bashkohen organizatës. I tillë ishte Rexhep Dauti nga Tanusha, i cili ishte komandant policie në Tanushë, Mulla Hajdar Kurteshi nga Kumanova – ish komisar politik i aradheve ushtarake të Sylë Hotlës, Mehmet Bushi, oficer – ush-

---

<sup>1823</sup> Lita, Qerim: “*KQ i NDSH-së dhe Azem Marana*”, Tiranë 2011, faqe 69.

<sup>1824</sup> Po aty.

<sup>1825</sup> Po aty.

tarak dhe oficer në Tetovë e Gostivar, Jetish Vishi nga Vitia e Gjilanit e shumë të tjerë nga Maqedonia Perëndimore, Anamorava dhe Karadaku i Shkupit.<sup>1826</sup>

Masivizimi i shpejtë i ONDSH-së në Maqedoni si dhe ndërlidhja e saj me Kosovën bëri që pjesët e ndryshme të rezistencës kombëtare në Kosovë dhe Maqedoni të ndërlidheshin ushtarakisht dhe politikisht, në mënyrë që lufta e tyre të jetë sa më e suksesshme. Kështu, në gusht të vitit 1945, “*Shtabi Suprem i Kosovës*” i drejtuar nga Adem Gllavica ftoi një takim të përfaqësuesve të njëjësive të kryengritësve shqiptarë dhe të organizatave të NDSH-së. Takimi u mbajt në Tanushë të Kopilaçës, më 15-16 gusht, midis Moravës së Epërme e Karadakut të Shkupit.<sup>1827</sup>

Komiteti i NDSH-së Shkupit, i cili ditë më parë edhe nga Hysen Tërpeza kisht marrë një ftesë për kongresin e përbashkët, për në Tanushë të Kopilaçës nisi Qemal Skënderin, Mexhid Zymberin, Rexhep Dautin dhe Xhemal Fazli Ferën.<sup>1828</sup>

Krahas përfaqësuesve të Shkupit në këtë tubim ishin edhe: Hysen Tërpeza, Adem Gllavica, prof. Ibrashim Kelmendi, Luan Gashi, Tefik Tanisheci, Hasan Kabashi – Vitia, Din Hoxha nga Kaçaniku, Qazim Sefa nga Llugaxhia, Qazim Soba, Hajriz Kajolli e të tjerë. Mbledhja mbajt në shtëpinë e Zylbehar Beqiri Ajvazi.<sup>1829</sup>

Hysen Tërpeza, bëri të ditur për lidhjet e vendosura me Komitetet e NDSH-së në Gjilan, Prishtinë, Prizren dhe së fundit edhe me atë të Shkupit. Në Kongres folën edhe Adem Gllavica, Luan Gashi dhe prof. Ibrahim Kelmendi, të cilët shpалosën platformën mbi të cilën duhej të zhvillohej veprimtaria kombëtare, qëllimi i së cilës është kundërshtimi i vendosjes së diktaturës sllavo-komuniste, mospranimi i copëtimit të trojeve shqiptare si dhe lufta për bashkimin shqiptar në një shtet demokratik dhe të lirë.

Kongresi emëroi Shtabin e Përgjithshëm të luftës me në krye Hysen Tërpezën në përbërje të të cilit ishin edhe Luan Gashi, Bajrush Xhakli (komandant i batalionit të dytë në malet e Presedelit), Rexhep Okllapi (komandant i batalionit të tretë në malet e Keçekollës), Shaban Haliti (komandant i batalionit të katërt), Syl Hasip Hotla (komandant i batalionit të pestë për Kumanovë e rrethinë) dhe

---

<sup>1826</sup> Po aty, faqe 73.

<sup>1827</sup> Shih: Bislimi, Daut: “*Një vështrim historik Organizatës së NDSH-së*”, Shkup 1997, faqe 49; Pirraku, Muahmet: “*Mulla Idriz Gjilani dhe mbrojtja kombëtare e Kosovës lindore 1941-1945*”, Prishtinë 1995, faqe 323; Basha, Sabile-Keçmezi: “*Veprimtaria atdhetare ilegale në Anamoravë*”, Prishtinë 2013, faqe 156; Arifi, Ferit: “*Tanusha në rrjedhat e historisë*”, Tetovë 2015, faqe 191.

<sup>1828</sup> Lita, Qerim: “*KQ i NDSH-së dhe Azem Marana*”, Tiranë 2011, faqe 80.

<sup>1829</sup> Arifi, Ferit: “*Tanusha në rrjedhat e historisë*”, Tetovë 2015, faqe 192.



Din Hoxha (komandant i batalionit të gjashtë). Në Shtabin e luftës ishte edhe Adem Gllavica i ngarkuar për propagandë. U vendos që prof. Ibrahim Klemendi të delegohet për propagandë në Shkup, ku NDSH do ta kishte selinë, kurse Luan Gashi do të kryente të njëjtat detyra në pjesët midis Suharekës dhe Prizrenit. Kongresi caktoi edhe komandantët e katër zonave operative.

Në fund, Kongresi doli me udhëheqjen e re të NDSH-së në krye me patriotin Halim Orana nga Gjilani. Qemal Skënderi u zgjodh zëvendëskryetar dhe Azem Marana sekretar i organizatës. Anëtarë të KQ të NDSH-së u zgjodhën: Hamdi Berisha, Mehmet Bushi, Hysen Rudi, Januz Balla, Mahmut Dumani, Hasan Bilalli, Haki Efendi Sermaxhaj, Osman Cani dhe Mitat Tërshana.

Kongresi miratoi disa dokumente si “Skemën e organizimit” dhe “Programin e Lëvizjes për Lirimin e Tokave Shqiptare” me pesë pika:

*1. Liri dhe pavarësi të plotë me të drejta vetëqeverimi në bazë të vullnetit të shfaqur lirisht;*

*2. Nën tokat shqiptare kuptohet krejt vendet, ku banojnë Shqiptarët, në 60% pa dallim se si quhet krahina e vendit dhe nga kush është pushtuar;*

*3. Lëvizja nuk ka qëndrim armiqësor kundër asnjë populli fqinjë, as kundër partive politike, vetëm insiston në mënyrë kulturore dhe me armë do të përpiqet t'i arrijë idealet shekullore të kombit shqiptar që të jetë i lirë dhe vetë sundues në shtet të vet me kufij etnik;*

*4. Mbasi të vendosën kufijtë etnik, pa marrë parasysh kushtet tjera të kufijve siç janë ato: strategjik, ekonomik, politik, etj... në mënyrë miqësore do të shkëmbehet popullata e pakicave nacionale, duke i tërhequr Shqiptarët që do të mbesin jashtë kufijve në vend të atyre që do të shpërngulen dhe do të përcillen jashtë;*

*5. Në kohë paqeje, Lëvizja nuk do të pushojë, por do të vazhdojë si shërbim roje të drejtave të popullit shqiptar, si të atyre të brendshme, ashtu edhe të atyre të jashtme, ndërkombëtar t'ua organizua për regjim me të vërtet demokratik dhe për relacione miqësore me popujt fqinjë ballkanik.<sup>1830</sup>*

Pas përfundimit të punimeve të Kongresit, të gjithë të deleguarit në qendrat e veta iu rrekën punëve për themelimin e komiteteve vendore të NDSH-së, të cilat duhej të marrin përsipër realizimin e vendimeve të marra në Kongres. Komitetet vendore të NDSH-së u themeluan në të gjitha rrethet e vendit, të cilat ishin të lidhura me Komitetin Qendror të NDSH-së në Shkup.

---

<sup>1830</sup> Shih: “Programi i Lëvizjes për Lirimin e Tokave shqiptar”, dokument, te Basha, Sabile-Keçmezi: “Vepërimtaria atdhetare ilegale e Anamoravës”, Prishtinë 2013, faqe 72.

Shema organizative e lidhur me qendrën në Shkup kishte arsye praktike, por edhe strategjike, me anën e të cilave synohej karakteri kombëtar i lëvizjes, ku Shkupi si qendër historike shqiptare kundërshtonte jo vetëm ndarjen që u ishte bërë Shqiptarëve në dy pjesë (Serbi – Kosova dhe Maqedonia Perëndimore në Maqedoni), por edhe demonstronte unitetin politik dhe shpirtëror në përputhje me të drejtën historike dhe etnike të tyre.

Kongresi i bashkimit në Tanushë të Kopilaçës si dhe platforma politike që u aprovua aty për veprim ushtarak dhe politik në të gjitha pjesët drejt sendërtimit të synimeve të përcaktuara: bashkimi kombëtar si dhe lufta kundër komunizmit krijoi një atmosferë mobilizimi te grupet e shkapërderdhura, por njëherësh ngriti gatishmërinë e pushtetit komunist jugosllav dhe atij shqiptar “në luftë të pa kompromis kundër reaksionit” dhe “shërbëtorëve të tyre”, që rëndom identifikoheshin si “kuislingë”, meqë kështu fshiheshin aspiratat dhe qëllimet e njëmendta siç ishte bashkimi kombëtar dhe lufta kundër komunizmit. Kështu, në Maqedoni dhe Kosovë, pushteti ushtarak, i cili nga fillimi kishte goditur pamëshirshëm gjithçka shqiptare, kishte filluar operacionet e gjera në ndjekje të pjesëtarëve të NDSH-së dhe të strukturave të tyre politike dhe ushtarake, që përhapeshin në të gjitha anët. Kreu i NDSH-së në Shkup, konkretisht prof. Ibrahim Kelmendi kësaj do t’i kundërpërgjigjet me hapjen e degëve të organizatës në të gjitha qytetet e vendit si dhe të shtrirjes së nëndegëve të tyre në thellësi si dhe me vënien e lidhjeve me përfaqësuesit e huaj në Maqedoni, ku me interes shfaqeshin ata anglezë dhe të Turqisë.

Lidhjet e para me përfaqësuesin e konsullatës britanike në Shkup si dhe me atë turk u vunë me anën e një letre që u ishte drejtuar diplomatëve anglezë dhe atyre turq, ku njoftoheshin me qëndrimin e Shqiptarëve të Maqedonisë dhe të Kosovës rreth bashkimit me Shqipërinë dhe se për këtë arsye “mijëra shqiptarë janë duke luftuar me shpresë të madhe se do të kenë përkrahjen e Perëndimit, posaçërisht nga faktori anglo-amerikan”.<sup>1831</sup>

Krahas këtij njoftimi të përgjithshëm, konsullit turk i ishte bashkangjitur edhe një njoftim tjetër në të cilin i bëhej me dije për veprimet përçarëse të pushtetit jugosllav, me anën e të cilave popullsia turke, jo vetëm që po mbështet politikën jugosllave ndaj Shqiptarëve, por disa aktivistë të saj janë vënë në shërbim të verbët të saj duke bërë çmos që ata të deklarohen turq.<sup>1832</sup>

---

<sup>1831</sup> Shih: Lita, Qerim : “*KQ i NDSH-së dhe Azem Marena*”, Tiranë 2011, faqe 86.

<sup>1832</sup> Po aty.

Profesor Ibrahim Kelmendi kërkon nga konsulli turk që të shqyrtojë seriozisht këtë çështje dhe të ndikojë te eksponentët e pushtetit jugosllavë të heqin dorë nga kjo politikë, e cila mund të jetë e dëmshme për të dy popujt.<sup>1833</sup>

Por, në vllugun e këtyre aktiviteteve politike, që po ndërmerre prof. Ibrahim Kelmendi nga Shkupi për masivizimin e NDSH-së me suksese të konsiderueshme, hetohet rënia e aktivitetit ushtarak si dhe tërheqja nga veprimtaria e kundërvënies së armatosur regjimit komunist jugosllav në përputhje me vendimet e Kongresit të Tanushës, kur edhe ishte themeluar “*Shtabi Suprem Ushtarak*” bashkë me zonat operative. Kjo kishte ndodhur pasi që Hysen Tërpeza komandant i “Shtabit të Përgjithshëm” në përputhje me një vendim që kishte marrë “Shtabi i Përgjithshëm” në fillim të tetorit në Tanushë, me anën e një letre, njoftonte qendrën e Shkupit për tërheqjen e “Shtabit Ushtarak” drejt Greqisë. Në këtë letër kërkohej nga prof. Kelmendi që të jepej pëlqimi i qendrës së NDSH-së për këtë veprim, i cili arsyetohej me qëndrimin që ishte marrë nga kërkesa që ushtarakëve (Adem Gllavicës dhe bashkëpunëtorëve të tij) u ishte drejtuar nga Mit’had Frashëri dhe Muharrem Bajraktari, që ata të kalonin në Greqi për të hyrë në shërbim të planeve globale anglo-amerikane për rrënimin e pushtetit komunist në Shqipëri dhe në Jugosllavi. Kurse “çështja e çlirimit dhe e bashkimit të tokave shqiptare të aneksuara nga Jugosllavia do të vijë si pasojë e ndryshimeve të sistemit në dy vendet fqinje, Shqipërisë dhe Jugosllavisë”.<sup>1834</sup>

Qendra e NDSH-së në Shkup nuk do të pajtohet me këtë vendim. Komiteti Qendror i saj reagoi me qëndrimin se do të luftohet deri në përmbushjen e idealeve kombëtare. Ngjashëm reagoi edhe Mulla Idrizi nga Gjilani, i cili me disa njësi ndodhej në pjesët e thella të malësisë së Karadakut. Ai kërkonte që të hiqej dorë nga arratia, sepse “nuk ka me shkue gjatë”.<sup>1835</sup>

Edhe përkundër thirrjes së KQ të NDSH-së si dhe të Mulla Idrizit dhe disa patriotëve të tjerë që gjendeshin nëpër njësitë guerile dhe luftonin për aq sa mundnin, forcat kryesore ushtarake, të drejtuara nga “Shtabi i Përgjithshëm”, nga tetorrit i vitit 1945 e deri në dhjetor, morën rrugën e vështirë dhe të rrezikshme të tërheqjes për në Greqi, që shumë prej tyre nuk do ta arrijnë, ngaqë forcat jugosllave do t’u vihen pas dhe hap pas hapi do t’i ndjekin duke u sjellë humbje të rënda, me ç’rast disa njësi do të shuhen fare.

---

<sup>1833</sup> Po aty.

<sup>1834</sup> ДАРМ, Документе: 1.1101.06.12-579-640.

<sup>1835</sup> Bislimi, Daut, vepra e cituar, faqe 52-53 dhe Pirraku, Muhamet, vepra e cituar, faqe 327.

Nëpër të tilla pusi vritet edhe Mefail Shehu – Zajazi, i cili mori rrugën për në Greqi me mbi 100 luftëtarë, por ra në një pritë partizane bashkë me shumë luftëtarë, të cilët ishin duke pritur që të bashkoheshin me njësitë tjera që kishin marrë këtë rrugë.

I fundit që u nis për në Greqi ishte grupi i Hysen Tërpezës dhe Hasan Kabashit. Këtë rrugë ata e morën nga gjysma e nëntorit. Atyre iu bashkuan edhe grupe të tjera që vepronin në Zhegoc, Kopilaçë të Ferizajt dhe Kaçanik.<sup>1836</sup>

Me largimin e njërive kryesore ushtarake të “Shtabit të Përgjithshëm” për në Greqi bashkë me ushtarakët e rëndësishëm që i drejtonin ato (fjala është për oficerë të shkolluar), filloi të bjerë edhe fuqia e rezistencës së armatosur ndaj regjimit sllavo-komunist, i cili kishte filluar të vendosej në Kosovë dhe në Maqedoni në përputhje me realitetet e Jugosllavisë komuniste, realitet ky që etninë e deriatëhershme shqiptare të shkëputur nga trugu i saj në vitin 1912, tash e ndante në dy pjesë: në atë brenda republikës së Maqedonisë - pjesë e federatës jugosllave, dhe në krahinën “provincën” e Kosovës nën Serbi. Kjo ndarje, bëhej edhe më e rëndë për Shqiptarët ngaqë Shkupi, qytet antik dhe kryeqendër e Vilajetit të Kosovës bashkë me Tetovën, Gostivarin dhe pjesët e tjera të Pollogut, shkëputeshin nga Kosova, qendër kjo graviteti politike e botës shqiptare nga Kriza Lindore e këndeje, me çka në rrethanat e reja që të dy pjesët marginalizoheshin së tepërmi. Si do të shihet, ndarja dhe diktatura komuniste, Beogradit dhe Shkupit do t’iu ofrojë mundësi të shumta që të vazhdohet politika e njohur antishqiptare e pasqyruar nëpërmes asimilimit dhe e shpërnguljes për në Turqi.

---

<sup>1836</sup> Bislimi, Daut, vepër e cituar, faqe 53.

## KAPITULLI I DYTË

### REPUBLIKA E MAQEDONISË DHE JUGOSLLAVIA

#### MAQEDONIA KRIJESË E TITOS

Ngritja e çështjes së Maqedonisë nga ajo gjeografike deri te politike, siç ndodhi në fund të shekullit XIX kur u fut në lojë për interesat hegjemoniste bullgare, serbe dhe greke të dirigjuara nga Rusia, si një gonetë kusuritje për qëllimet e strategjike, epilogun do ta fitojë në kuadër të Jugosllavisë së Titos, si pjesë e federatës së shtetit të ri komunist të themeluar në Jajce, në kuvendin e dytë të AVNOJ-it (KAÇKJ-së) më 29 nëntor 1943. Jugosllavia federative e Jajcës shfaqej me gjashtë republika të barabarta: Serbia, Kroacia, Sllovenia, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia. Koncepti i shtetit federativ i Kuvendit të Jajcës mori “legjitimitetin” përfundimtar në Kuvendin e Tretë të AVNOJ-it në Beograd, në vitin 1945, me ç’rast njësitë federative, në bazë të vendimeve të Kuvendit të Jajcës, deklaruan “vullnetin e tyre burimor” për t’iu bashkuar federatës së re jugosllave.

Natyrisht se ky “vullnet i lirë” i njësive të reja federative kishte karakter ideologjik, ngaqë buronte nga Këshillat Nacionalçlirimtare, një lloj pushtetipopullor, i krijuara gjatë luftës, nën direktivat e Partisë Komuniste të Jugosllavisë, forcës kryesore politike, e cila, në aleancë me frontin antifashist botëror (SHBA-të, Bashkimi Sovjetik, Britania e Madhe dhe Franca), doli me “hisen” e fitueses së luftës.

Edhe pse mbledhja e dytë e AVNOJ-it e organizuar nga shpura partizane e Titos dhe bashkëpunëtorët e tij komunistë kroatë dhe sllovenë, nuk kishte kurrfarë legjitimiteti “të pushtetit vendor”,<sup>1837</sup> ngaqë të ashtuquajturat Këshilla Nacionalçlirimtare në të cilat thirrej AVNOJ-i ishin më shumë në letër se në

---

<sup>1837</sup> Më gjerësisht rreth AVNOJ-it si një instrument të Titos për ambiciet e tij politike dhe ushtarake si dhe konceptin e tij ideologjik për të ardhur në pushtet me çdo kusht me ndihmën e bolshevizimit me ç’rast do të përdoren të gjitha metodat e mundshme të luftës revolucionare, siç ishte ajo partizane, shih Đilas, Milovan: “*Der Krieg der Partisanen. Jugoslawien 1941-1945*”, Molden, Wien, München, Zürich, Insbruck, 1977.

vepër, meqë në shumë pjesë të vendit as që ishin të konstituuar (në Maqedoni, Serbi dhe Slloveni) nga shkaku se Jugosllavia e Versajës, pas sulmit gjerman të vitit 1941, ishte shpërbërë dhe në pjesët e saj të dikurshme ishin krijuar shtetet tjera (Serbia e kuislinge e Nediqit, Kroacia e Pavarur) ose u ishin bashkuar etnive prej nga ishin shkëputur dhunshëm (një pjesë e Kosovës dhe Maqedonisë Perëndimore “Shqipërisë së Madhe” nën kurorën e Imperisë së Italisë dhe pjesa tjetër i ishte bashkuar Bullgarisë së Madhe), megjithatë, Tito ia doli që, luftën e përbashkët partizane, të përqendruar të shumtën në pjesët malore të Bosnjës Qendrore, në raport me fuqitë e mëdha (SHBA-të, Bashkimin Sovjetik dhe Britaninë e Madhe) ta kushtëzojë me rikthimin Jugosllavisë së re mbi parimet federative, që do të di-zajnohejnë përputhje “me konceptin ideologjik të barazisë klasore të popujve të barabartë”, të cilët, në federatën e re do të hynin “me vullnetin demokratik” të fituar gjatë luftës antifashiste.<sup>1838</sup>

Depërtimi i Armatës së Kuqe Sovjetike në tetorin e vitit 1944 nga Bullgaria dhe Rumunia në betejat e fundit për çlirimin e hapësirës së ish Jugosllavisë si dhe fitorja e partizanëve në frontin e Sremit e deri në Trieste në prill 1945, Titos ia lanë duart e lira që të vendoste për shtetin e ri komunist, por edhe për raportet e reja që do të dilnin në rajon (Shqipëri, Bullgari dhe Greqi), ku Jugosllavia shfaqej si faktor rajonal, ngaqë lëvizja partizane që kishte organizuar dhe drejtonte, në raport me sovjetikët, ishte “autentike”.<sup>1839</sup>

Në përputhje me këtë strategji, para Titos shtroheshin detyra të ngutshme dhe të dyfishta që në Serbi dhe Maqedoni, futja e aradheve partizane dhe terrori i tyre ndaj forcave nacionaliste dhe patriotike të shfrytëzohej për krijimin e Këshillave nacionalçlirimtare si dhe Komiteteve Partiake, lidhja e të cilave me “qendrën” kishte qenë thujse formale. Kështu, në Serbi, këshillat nacionalçlirimtare u krijuan pas depërtimit të Armatës së Kuqe sovjetike, me ç’rast u konstituua edhe organizata e Partia Komuniste e Serbisë në nivel të vendit, kongresi themelor i së cilës u mbajt në maj 1945.<sup>1840</sup>

Për ta arritur këtë në Serbi, Titoja nuk e kishte gjithaq të vështirë, ngaqë i mjaftuan disa lidhje formale midis PKJ-së me një grup komunistësh serbë të lidhur me Kominternin (Rankoviçin, Vesilinin, Koqa Popoviçin e të tjerë), të krijuara në fillim të vitit 1941, në konferencën IV vendore në Zagreb. Grupin

<sup>1838</sup>Shih: Bilandić, Dušan: „*Historia Socialističke Federativne Republike Jugoslavije*“, Zagreb, 1979.

<sup>1839</sup> Shih: Pirjevac, Jože: „*Tito, Stalin in Zahod*“, Ljubljana, faqe 133; Dimitrov, G: „*Dnevnik 1933-1947*“, Sofje faqe 528; Dedijer, V: „*Novi Prijelozhi za biografiku Josipa Broza Tita*“, III, Beograd, 1984, faqe 311.

<sup>1840</sup> Shih: Dedijer, V: „*Novi Prijelozhi za biografiku Josipa Broza Tita*“, III, Beograd, 1984, faqe 447-487 dhe Pirjevac, Jože: „*Titovi i Drugovi*“, Zagreb, 2012, faqe 90-102.

komunist serb Titoja e mbante rreth vetes në shtabet partizane, duke i quajtur “përfaqësues” politikë dhe ushtarakë të Serbisë.<sup>1841</sup>

“Vonesa” serbe, në raport me konceptin e Jugosllavisë së AVNOJ-it, nuk e pengoi Titon, që pas grushtit që ua dha forcave çetnike në Bosnjën Qendrore dhe Serbinë Lindore dhe Jugore, nëpërmes Këshillave Antifashistë, ku rëndom u shfrytëzuan grupet dhe njësi guerile të shkapërderdhura partizane, të konvertuara në pushtet popullor, të përshpejtojë themelimin e “pushtetit popullor” në mënyrë që të merrte përsipër edhe detyrat ekzekutive, me çka edhe Serbisë i krijoheshin kushtet formale për përfshirjen në shtetin e ri federativ.<sup>1842</sup>

Për të qenë absurdi më i madh, në bisedimet e Visit të marsit të vitit 1945 dhe të tjerat, ku do të vendosej edhe për fizionominë e njësisve federative (republikave) me ç’rast Serbisë, për ta mbajtur pranë ngaqë sjellja e saj ishte vendimtare për konceptin e rikthimit të Jugosllavisë së AVNOJ-it, do t’i përcaktohen edhe dy krahina autonome (Vojvodina me autonomi të gjerë dhe Kosova si “obllast”), në këto bisedime, midis Titos, Kardelit dhe Bakariqit, nuk merrte pjesë asnjë serb.<sup>1843</sup>

Këtu e ka zanafillën edhe ajo thënia lapidare e Vladimir Bakariqit: “Serbinë, me dy krahina (Kosovën dhe Vojvodinën) “e bëmë”, ndonëse nuk e kishim ende Serbinë”!<sup>1844</sup>

Absurditetin e “bërjes së Serbisë” dhe pa serbë dhe pa qenë e konstituuar Serbia federative, e shpjegon fare mirë edhe rasti i Kosovës dhe “i kërkesës” së saj të dalë nga Kuvendi i Prizrenit i 10 korrikut 1945 në rrethanat e gjendjes së luftës të vendosur në mars të atij viti me vendimin e Shtabit të Përgjithshëm të UNÇJ-së, me rastin e “shpërthimit të kundërrevolucionit”, për “t’iu bashkuar Serbisë demokratike”, të cilën delegatët e saj Mehmet Hoxha (kryetar i Konferencës së Bujanit) dhe Dushan Mugosha (themelues i Partisë Komuniste të Shqipërisë), është dashtë t’ia dërgojnë Serbisë, por që u desh të presin mbledhjen e AVNOJ-it serb, në shtator të atij viti, kur do të merret vendimi për Serbinë federative në përbërje të Jugosllavisë Federative që do të konstituohet në Kuvendin e tretë të AVNOJ-it në nëntor 1945, Beograd.<sup>1845</sup>

---

<sup>1841</sup> Đilas, Milovan: „Tito. Eine kritische Biographi“, Wien, 1980-

<sup>1842</sup> Marković, Draža: „Dnevničke zabaleške“, Beograd, 1987; Bogdanović, Dušan: „Istine bez distance“, Beograd 1986; Ćosić, Dobrica: „Stvarno i moguće“, Rijeka, 1982; Bilandić, Dušan: „Povijesti izbliza“, Memoarski zapisi 1945-2005“, Zagreb, 1999.

<sup>1843</sup> Shih Pirjevac, Jože: “Tito i Drugovi”, Lubjana, 2012 dhe Dedijer, Vladimir: “Novi prilozi za biografiju Josipa Broza Tita” II dhe III, Zagreb, 1984.

<sup>1844</sup> Po aty, faqe 225.

<sup>1845</sup> Petranović, Branko: “Istorija Jugoslavije 1918-1978”, Beograd, 1986; Pleterski, Janko: “Nacije, Jugoslavija, revolucija”, Beograd, 1980; Bilandić, Dušan: “Historia Socialističke Republike Jugoslavije”, Zagreb,

Nëpër skenarë të tillë të dirigjuar nga kruzhoku komunist i Titos dhe jashtë çdo kriteri “demokratik” do të shfaqet edhe Maqedonia, një krijesë politike me emërtim antik, ani pse as gjeografikisht, as historikisht e as nga pikëpamja etnike republikën e re të popullit maqedonas, me asgjë nuk e lidhte me Maqedoninë antike. Ndërsa sajesa “sllavo-maqedonase” nga mesjeta e vonshme – një amallgam bullgar-vllah-sllav, i shkëputur nga amëzat e tyre shoqërore dhe politike - nuk kishte qenë në gjendje që të krijojë një identitet të qëndrueshëm etnik.<sup>1846</sup>

Edhe i ashtuquajtur “sfond historik” nga kryengritja e Ilindenit dhe Republika e Krushevës e vitit 1903, që do të theksohet në Manifestin e Kuvendit të ASNOM-it, “si burim shtetësie”,<sup>1847</sup> është pa ndonjë mbështetje të qëndrueshme historike, ngaqë as në Ilinden e as në Republikën jetëshkurtër të Krushevës nuk përmendet askund fjala Maqedoni e as emërtimi “maqedonas”. Madje, edhe slogani “Maqedonia maqedonasve”, nuk paraqet ndonjë fakt të qëndrueshme politik, ngaqë kjo thirrje, nga Kriza Lindore, do të shfrytëzohet si koniunkturë midis interesave hegjemoniste bullgare, serbe dhe greke në rajon për ta ndarë midis tyre me pretendime etnike, veçmas këtyre të parëve, të cilët “*Ilindenin*” historikisht e trajtojnë lëvizje bullgare.<sup>1848</sup>

Kështu, ish vilajeti i Kosovës dhe pjesërisht i Manastirit deri në vitin 1912, të shumtën i banuar me shqiptarë etnikë, si Banovinë e Vardarit gjatë mbretërisë jugosllave, së cilës edhe nga Beogradi do t’i mohohet çfarëdo identiteti etnik dhe historik maqedonas, duke u shpallur serbë dhe, ndërkohë që Bullgaria vazhdonte ta trajtonte “ajkë” bullgare nga mbretëria e Samuilin, nga komunistët jugosllavë kthehet në një republikë, e përcaktuar që do t’i bashkohet federatës jugosllave. Asaj do t’i njihet edhe “kombi maqedonas”, si një “popull autokton”, ndonëse nga fundet e shekullit XIX e këndej shfaqet si emërtim “sllavo-maqedonas”, pa identitet kombëtar dhe kulturor.<sup>1849</sup>

---

179; Vlačić, Gordana: “*Revolucija i nacionalo pitanje*”, Zagreb, 1984; Pirjevac, Jože: “*Jugoslavija 1912-1992*”, Trieste, 1990.

<sup>1846</sup>Shih: Cvijić, Jovan: „*O etnografiji Makedonskih Slovena*“, Beograd, 1906.

<sup>1847</sup> Димитрова, Евгени: „АСНОМ“, документи, Скопје, 1996.

<sup>1848</sup>Shih: “*История в България*“, Софија, 1981; Василиев, В. А; Божин Војнов: „*Българската Просвета в Македонија и одридска Тракија 1878-1913*“, 1982.

<sup>1849</sup>Rreth amallgamit “sllavo-maqedonas” pa identitet etnik dhe kulturor, rëndom e quajtur “masë popullore sllovene”, etnografi i njohur serb, Cvijić thotë se “masa popullore e sllovenëve maqedonas nuk posedon kurrfarë vetëdije, ngaqë nuk ka pasë të kaluar të pavarur historike, as gjuhën e vet letrare. Andaj, për këtë popullatë sllovene ekzistojnë tri pikëpamje: se është e afërm me serbët, se është përngja gjaku bullgare dhe mbase gjuhësisht e pavarur”. Në përputhje me këto, Cvijić nxjerr përfundimin se „nuk ka fakte meritore etnografik, me të cilat, masa popullore sllave do të mund të quhej serbe ose bullgare. Madje, edhe rreth emërtimit „bullgar“ me të cilin identifikohen sllavet maqedonas, nuk është emërtim etnografik, gjë që sipas Cvijiqit, „kjo popullatë nuk e



Këtij akti dhe “përligjjes” së tij do t’i hapet rruga nga forcat e bashkuara partizane (jugosllave, atyre nga Shqipëria dhe të aradheve partizane nga Kosova dhe Maqedonia) të krijuara gjatë ose pas tërheqjes së forcave gjermane, kur ato, pas një lufte të ashpër tre mujore me forcat nacionaliste shqiptare në Kosovë dhe Maqedoninë Perëndimore, të bashkuara në një luftë për jetë a vdekje kundër ripushtimit sllavo-komunist, u futën në ato pjesë për ta shpallur fitoren e frontit antifashist dhe njëherësh edhe fitoren e “pushtetit të ri popullor” komunist nën petkun e shtetet “të ri” maqedonas.<sup>1850</sup>

Përligjja e kësaj “fitore” megjithatë, në Maqedoni, ka edhe preludin e vet, paksa të veçantë, nga fakti se hapësira e banovinës së Vardarit, të cilën e kishte pushtuar Serbia në Luftën e Parë Ballkanike dhe gjatë luftës së parë botërore, për katër vjet gjatë luftës së dytë botërore kishte qenë pjesërisht nën Bullgari dhe pjesërisht nën Shqipëri. Kështu që, në këto pjesë, organizatat e pakta komunistekishin qenë sa për sy e faqe dhe vetëm në letër të lidhura me PKJ-në e Titos. Njëjtë ishte edhe me këshillat nacionalçlirimtarë nga defterët e Tempos, që do të fillojnë të dalin prej tij, pas kapitullimit të Italisë në 1943 dhe të kapitullimit të Bullgarisë fashiste në shtator 1944. Njëjtë do të ndodhë edhe me aradhet

---

ka të përcaktuara ndjenja të etnisë, të përkatësisë etnike tek një popullsi e caktuar, siç nuk e ka as ndërgjegjen as të serbe, as të asaj bullgare, megjithëse është e afërt edhe me serbët edhe me bullgarët. ( Shih: Cvijić, Jovan: „O etnografiji Makedonskih Slovena“, Beograd, 1906, faqe 6-9.) Këto vlerësime kundërshtohen edhe nga probullgarët dhe proserbët e shumtë, të cilët përpiqen që popullatën sllave ta shohin „bullgare“ ose „serbe“. Kështu, J. Ivanoff në librin „La Question Macedonienne“, Paris 1920, mbron qëndrimin se popullata e Maqedonisë gjuhësisht dhe etnikisht është bullgare, ndërsa Maqedoninë e vlerësin si koncept historik të dalë nga mesejta, i panjohur nga Perandoria Osmane, për t’u kthyer në „skenën hisotrike“ nga kryengritjet bullgare. Edhe Grigoroviq Viktor, të gjithë sllavët e Maqedonisë i quan bullgar, ndërsa gjuhën e tyre bullgare. Këto teza ai i mbështet te P. J. Shafarik, B. Dimov e të tjerë. ( Shih: K.Cestreich „Die Bevölkerung von Makedonien“, Georg. Zeitschrift 1905, faqe 285). Tezat për Maqedoninë proserbe dhe popullatën e atjeshme kryesisht serbe, duke i llogaritur të tillë edhe shqiptarët „të islamizuar nga osmanët“, përhapen nga Jastrebov, Spiridon Gopçeviq ( „Makedonien un Alt Serbien“, Wien, 1889), Haxhivsiljeviq ( „Arnauti-naše krvi arnautasi“, Beograd 1938), Orloviq, P: („Stara Srbija i Arbanasi“, Neograd 1901), Stojançeviq V („Kosovo i Metohija u srpsko-arbanaškim odnosu u XIX veku 1804-1878“, Beograd 1994) e të tjerë, qëndrimet e të cilëve, pa argumente shkencore, përkojnë me propagandë politike për qëllime hegjemoniste.

<sup>1850</sup> Rreth bashkëpunimit të lëvizjes komuniste si dhe të luftës së aradheve partizane në kuadër të Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar midis Jugosllavisë, Shqipërisë dhe Bullgarisë si dhe operacioneve të përbashkëta të njësi-ve partizane në Maqedoni dhe Kosovë pas kapitullimit të Bullgarisë në shtator 1944 dhe të tërheqjes së forcave gjermane nga Greqia, Shqipëria dhe Jugosllavia në tetor-dhjetor 1944, shih gjerësisht: Dedijer, Vladimir: „Novi prilozhi za biografiju Josipa Broza Tita“, 1986; „Historia e Popullit Shqiptar“ IV, Tiranë, 2002; Kodra Masar : „Shqiptarët e Maqedonisë gjatë Luftës së Dytë Botërore 1939-1944“; Vukmanoviq, Sfetozar-Tempo: „Revolucija koja teče“, Beograd 1982; Старова, Вулнет: „Заедничко живлење - албанската народност во СР Македонија“, 1988; Никодиновски, Борис: „Одбрандеба регионализација на Република Македонија“, 1994; Lleshi, Haxhi: „Vite, njerëz, ngjarje“, Tiranë, 1996; Ostreni, Gëzim: „Shpresa dhe zhgënjimi i shqiptarëve gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore“, Pejë, 2000; „Исторична Македонска Народ“, Скопје, 1999; „Македонија 1945-1995“, Скопје, 1996; Lita, Qerim: „Territoret lindore shqiptare 1912-1960“, Shkup, 2012 dhe „Tokat e bashkuara 1941-1944“, dokumente në katër vëllime, Shkup, 2014.

partizane thujse simbolike dhe jashtë çdo veprimtarie luftarake,<sup>1851</sup>të cilat, me direktiva të Titos, brenda natës do të kthehen në batalione dhe korpuse madje.

Gjendje e ngjashme ishte edhe në pjesën e Maqedonisë Perëndimore (Tetovë, Gostivar, Dibër) të rikthyera në kuadër të Shqipërisë së Madhe gjatë pushtimit italian dhe pas ardhjes së gjermanëve në kuadër të Shtetit të Pavarur Shqiptar, të shpallur nga Lidhja e Prizrenit në tetor 1943 deri në tetor 1944, ku pushteti mbahej nga forcat nacionaliste, ndërkohë që grupimet partizane po rigrupoheshin nga pjesët të banuara me popullatë maqedonase.<sup>1852</sup>

Por, Titoja, siç kishte vepruar edhe me realitetet tjera politike të dala pas shkatërrimit të Jugosllavisë së Versajës në qershor 1941, kur idenë e “shtetit të përbashkët” e kishte mbajtur me anën e organizimit të përbashkët partiak dhe të këshillave nacionalçlirimtare “si pushtete popullore” në kuadër të aleancës së gjerë antifashiste, ngjashëm kishte vepruar edhe me viset e banovinës së Zetës dhe të Vardarit (ish vilajetin e Kosovës dhe të Manastirit të pushtuara nga Serbia në vitin 1912), duke ua ruajtur “vegëzën” e lidhjes partiake me “amëzën” jugosllave. Për këtë arsye, në pjesën më të ndjeshme të puqjeve gjeopolitike dhe gjeostrategjike nga kriza lindore e tutje, Tito kishte dërguar një bashkëpunëtor tepër dinak, por shumë strateg, Svetozar Vukmanović – Tempon, përgjegjës për “bazën komuniste” në trekëndëshin Shkup-Tiranë-Beograd si dhe për këshillat nacionalçlirimtare, që duhej të ruanin këtë përcaktim.<sup>1853</sup>

Në të vërtetë, Svetozar Vukmanović-Tempo, jo vetëm që ia kishte dalë të mbikëqyrë gjendjen në përputhje me direktivat e Titos në rrafshin partiak, por edhe në aspektin shoqëror dhe politik. Duke mos u konfrontuar me realitetet (bashkimin bullgar në pjesën më të madhe dhe atë shqiptar në pjesën perëndimore), por që në ato rrethana, të agjitojë për një luftë “të përbashkët antifashiste që njëherësh do të sillte edhe çlirim kombëtar nga pushtimet jugosllave”, ia kishte dalë që “idenë e çlirimit” ta lidhte me lëvizjen komuniste jugosllavë dhe

---

<sup>1851</sup> Gjendjen jashtë mbikëqyrjes jugosllave (partiake dhe të lëvizjes partizane) në Maqedoni në rrethanat e pushtimit bullgar si dhe në pjesët e Maqedonisë që i ishin kthyer Shqipërisë, më së miri e pasqyron Dobrivoje Radosavleviq, i dërguar i i Titos në Maqedoni, në vitin 1943, me rastin e ardhjes në Shkup për të drejtuar lëvizjen partizane. Në një letër dërguar Tempos, Radosavleviq, pos tjerash shkruan se “Aradhat partizane të organizuara gjatë muajve të verës së vitit 1942 janë të shkatërruara, kështu që vetëm disa luftëtarë kanë mbetur gjallë dhe ata fshihen të miqtë e tyre nëpër qytete dhe fshatra. Një aradhë ka arritur të kalojë në Maqedoninë e Egjeut dhe gjendet në fshatrat rreth Fëllërinës dhe Kosoturit për të kaluar dimrin.” Radosavleviq flet ngjashëm edhe për organizatat partiake të PKJ-së. Thotë se në shumë vende janë shpërndarë, ngaqë kuadrot udhëheqëse ose janë vrarë ose janë arrestuar dhe gjenden nëpër bugje dhe kampe përqendrimi. (Shih: Vukmanović, Svetozar-Tempo: „Revolucija teče dalje“, memoari I,II, Lubjana, 1972.)

<sup>1852</sup>Vukmanović, Svetozar-Tempo: „Revolucija teče dalje“, memoari I,II, Lubjana, 1972.

<sup>1853</sup>Po aty.

organizatat e tyre partiake. Krahas lidhjes partiake me “bazën” jugosllave, Tempo ia kishte dalë që edhe frontin antifashist (aradhet partizane në Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë) t’i vente nën mbikëqyrjen e Frontit Nacionalçlirimtar të Jugosllavisë, që drejtonte Tito dhe grupi i tij komunist, të cilit, pas mbajtjes së mbledhjes së dytë të AVNOJ-it, në nëntor 1943 në Jajce, ia kishte krijuar edhe platformën e pushtetit që do të vendosej pa luftës në kuadër të Jugosllavisë Federative Demokratike.<sup>1854</sup>

Në këtë rrugë, siç dihet, Tempoja, në Shqipëri parandaloi dy zhvillime strategjike: bashkimin e frontit antifashist shqiptar të arritur në Mukje me të cilin do të ruhej bashkimi shqiptar në përmasat etnike, i cili pjesërisht ishte rivendosur pas shkatërrimit të Jugosllavisë së Versajës në vitin 1941, dhe njëherësh, gjithnjë në përputhje me këtë koncept, do të pengojë edhe jetësimin e Rezolutës së Bujanit të dhjetorit të vitit 1943 janarit të vitit 1944, me çka Kosovës do t’i krijohen rrethanat që në saje të pajtimit internacionalist të komunistëve të shqiptarë me ata jugosllavë Kosova të ripushtohet nga partizanët jugosllavë dhe të mbetet nën Serbi, si “oblast”. Ndërsa në Maqedoni, me krijimin e Partinë Komuniste të Maqedonisë të lidhur me PK të Jugosllavisë (ndonëse me një grusht anëtarësh të shumtën maqedonas të lidhur me Serbinë, ku kishte edhe disa shqiptarë)<sup>1855</sup> dhe Këshillin Antifashist nacionalçlirimtar të Maqedonisë, pra të shkëputur nga Bullgaria, të lidhur me Jugosllavinë, edhe pse ajo nuk ekzistonte si e tillë, ia kishte dalë që të përjashtojë organizimin partiak bullgar e me të edhe ndikimin e shtuar sovjetik.<sup>1856</sup>

Në Maqedoni, këto zhvillime, gjithsesi se lidhen me fazën e fundit (vjeshtë 1943- maj 1945) si dhe rrethanat që solli së pari kapitullimi i Italisë, pastaj kapitullimi i Bullgarisë fashiste, ndërkohë që pas depërtimit të Armatës së Kuqe në Rumani dhe Bullgari, fronti antifashist ndodhej në ofensivë të plotë dhe pritej fitorja e pashmangshme, siç do të ndodhë në maj 1945.

Në vigjilje të këtyre ndryshimeve por edhe gjatë tyre, Tempo shfaqej si strumbullar i gjitha veprimeve të shpejta me anën e të cilave lufta antifashiste përmes aradheve partizane qofshin ato edhe simbolike nga fundi i vitit 1942 në disa zona të shkëputura në kufi me Maqedoninë e Egjeut si dhe baza partiake në Maqedoni duhej t’i nënshtroheshin konceptit jugosllav të Titos. Në këtë zhvillim, gjithnjë në përputhje me strategjinë e Tempos që hapësira e lëshuar nga fashistët

---

<sup>1854</sup>Po aty.

<sup>1855</sup> Shih: Musliu, Abdullah: “Ditari 1941-1945”, Frizaj, 2016.

<sup>1856</sup>Vukmanović, Svetozar-Tempo: „Revolucija teče dalje“, memoari I,II, Ljubana, 1972.

bullgarë dhe e gjermanëve në Maqedoni dhe Kosovë të mos lejohej të merrej nëdorë nga “forcat nacionaliste shqiptare dhe bashkëpunëtorët e mbetur të fashizmit” edhe pse ato në Maqedoninë Perëndimore i vlerësonte si shumë të forta dhe të organizuara mirë,<sup>1857</sup> do të involvohen partizanët jugosllavë me aradhet e tyre nga Serbia dhe Mali i Zi si dhe ato vendore, të krijuara se voni dhe ad-hoc, të cilat duhej të plotësoheshin me të tjera nga mobilizimi që kishte filluar me të madhe. Ato duhej të përcilleshin edhe me formimin e këshillave nacionalçlirimtare si pushtet i përkohshëm popullor, me të cilat do të luftoheshin të gjitha strukturat “nacionaliste”.

Në këto rrethana, filloi edhe faza e fundit e betejës së Titos për konceptin e Jugosllavisë së re federative dhe të krijimit të njërive të saj në përputhje me vendimet e AVNOJ-it të parë nga viti 1943, ku Maqedonia kishte një rëndësi të veçantë, ngaqë në njërin anë pengohej çfarëdo projekti perëndimor për mbajtjen e Shqipërisë etnike, si një kundërpërgjigje eventuale ndaj planeve sovjetike për futjen e Ballkanit në sferën e ndikimit në përputhje me depërtimin e Armatës së Kuqe, e cila po i afrohej Adriatikut dhe Italisë, dhe në tjetrën anë, me dhënien e Kosovës Serbisë, “reaksioni serb” të fashitej paksa, ngaqë krijimi i Maqedonisë përfundimisht e hiqte atë nga “çështja bullgare” për ta kthyer në atë jugosllave gjithnjë në përputhje edhe me interesat serbe në të.

Por, beteja për Maqedoninë, ku Tempoja me shtabet e tij të infiltruara prej kohësh në drejtim të maqedonasve me prirje jugosllave dhe shqiptarëve të rreshtuar nga e majta, që gjithnjë e më shumë e mbizotëronte Frontin Antifashist dhe strukturat e këshillave nacionalçlirimtare të dala prej saj, u trimërua edhe me shumë nga peshat që Tito fitoi në rivalitetin midis blloqeve të mëdha brenda frontit antifashist: midis atij komunist të drejtuar nga Stalini dhe atij perëndimor të drejtuar nga SHBA-ja dhe Britanikët, ku ai shfaqej si një faktor shumë i rëndësishëm i luftës, ngaqë partizanët e tij, ishin të vetmit që mund të ndikonin thyerjen e forcave fashiste në rajon pa lejuar që ai të dominohej i gjithi nga sovjetikët. Natyrisht se Titoja, i vetëdijshëm për peshën që kishte fituar pas kapërcimit të

---

<sup>1857</sup> Në librin “*Revolucija tece dalje*”, III, Lubjanë, 1972, Tempo përshkruan hollësisht gjendjen në Maqedoninë Perëndimore pas kapitullimit të Italisë fashiste në 1943, me ç’rast Fronti Nacional Shqiptar, të cilat ai i quan „fuqi balliste“, mbanin pushtetin. „Ishin gati që me armë ta imponojnë mbajtjen e Dibrës në kuadër të Shqipërisë, ngaqë partizanët nga Shqipëria, nga ana tjetër, nuk kishin fuqi të mjaftueshme, por edhe nuk ishin të gatshëm t’u kundërvihën qëllimeve të këtyre të Ballistëve. Rrugëdaljen duhej kërkuar në marrëveshjen mes partizanëve shqiptarë dhe atyre maqedonas. Ata duhej t’u rezistonin qëllimeve të ballistëve për vendosjen e pushtetit të tyre në qytet, nëse duhej, edhe me forcë. Përveç kësaj duhej ndërtuar pushtet të ri me pjesëmarrjen e barabartë të të dy popujve. Qytetarëve do t’u lejohej ta nxirrnin flamurin maqedonas ose shqiptar. Do të shpallej barazia e gjuhsë shqipe me atë Maqedonase“. (Shih: Libri III, faqe 108).

forcave çetnike serbe në radhët e nazistëve si dhe lidhjen e fatit me humbësit e pashmangshëm, do të shfrytëzojë gjendjen e krijuar edhe për marrëveshje me sovjetikët, që me miratimin e tyre të kthehej edhe në një lider komunist rajonal dhe me të drejtë madje, ngaqë prej kohësh dominonte në tërësi Partinë Komuniste në Shqipëri si dhe frontin antifashist atje. Gjatë takimit me Stalinin në Rusi, ku u prit me nderime të mëdha, Tito ia mori “pahun” edhe Dimitrovit. Kjo u pa më së miri nga krijimi i frontit të përbashkët partizan midis aradheve bullgare dhe atyre që do të formohen shpejt e shpejt nga jugosllavët, në të cilat do të marrin pjesë maqedonas dhe shqiptarë, por që do të drejtohej nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë, pra nga Titoja që tashmë shfaqej si mareshal.<sup>1858</sup>

Si do të shihet, me këtë veprim, pra me marrëveshjet me Dimitrovin (deri më atëherë bashkëpunëtorin kryesor të Stalinin për Ballkanin), Titoja pos që u kthye në adresë të parë të aleatëve për rajonin, njëherësh ia doli që Bullgarisë t’ia heq pretendimet e njohura të saj ndaj Maqedonisë që e konsideronte “krahinë bullgare”, ndërsa maqedonasit “bullgar të mirëfilltë”, gjë që krijoi rrethanat për një federatë të re ballkanike (natyrisht komuniste) midis Jugosllavisë, Bullgarisë dhe Shqipërisë, një “mini” shtet sovjetik në Ballkan, nën udhëheqjen e Titos, që edhe do të mund të ndodhte, po mos të pengohej nga Stalini, i cili me të shpejtë hetoi se federata ballkanike nën Titon dinak dhe me peshë të shtuar politike në rajon, mund t’i kthehej në bumerang Bashkimit Sovjetik, nga mundësia e ndikimit amerikan për t’u kthyer në një “faktor përçarës” për botën komuniste.<sup>1859</sup>

Në Maqedoni, krijimi i strukturave “të pushtetit popullor” prapë i takoi “arkitektit politik” të Titos për trekëndëshin Maqedoni-Kosovë-Shqipëri, S. V-Tempo. Ishte e pritshme që njeriu i cili me një shkathtësi të madhe ia kishte dalë që në të gjitha pjesët të infiltrojë ndikimin komunist dhe prapagojë edhe “të ardhmen e përbashkët të të gjithë popujve të shtypur deri më dje” edhe aty ku ai ishte fare absurd (në Maqedoninë Perëndimore, ku shteti i bashkuar shqiptar shqiptarëve ua kishte kthyer dinjitetin dhe kulturën kombëtare), të merrte përsipër këtë punë. Kështu, më 1 gusht 1944, thirri Kuvendin e ASNOM-it (Антифа-

---

<sup>1858</sup> Grada e “mareshalit” Titos iu dha në mbledhjen e AVNOJ-it, në Jajce më 29 nëntor 1943. Sipas biografit të Titos, V. Dedijer, grada e mareshalit nga Titoja ishte futur në përdorim edhe para se ta merrte, në disa dekrete të tij në raport me britanikët, të cilëve duhej t’u imponohej që t’ia njihnin edhe pushtetin politik dhe atë ushtarak në raport me atë të mbretërisë jugosllave, gjë që edhe do të ndodhë në fillim të vitit 1944. (Shih: “*Novi prijedlozi za biografiku Josipa Borza Tita*”, 1984 si dhe Gibonskij, Leonid: „*Sovjetski Sojuz i Novaja Jugoslavija 1941-1947*“, Moskva, 1987).

<sup>1859</sup>Dedijer, Vladimir: „*Iz gubljeni boj J.V. Stalina 1948-1955*“, Lubljana, 1969.

шистићко Собранјена Народнота Ослободувањена Македонија), që u mbajt, jo rastësisht në manastirin ProhorPçinski (në afërsi të Kumanovës).<sup>1860</sup>

Në këtë kuvend, i drejtuar fund e krye nga Tempo dhe bashkëpunëtorëve të tij, e ku morën pjesë edhe përfaqësues ushtarakë amerikanë, britanikë dhe sovjetikë, 116 delegatë, do të deklarohen për themelimin e Republikës së Maqedonisë në kuadër të Jugosllavisë Federale të AVNOJ-it në Jajce, më 29 nëntor 1943. Republika e Maqedonisë shpallej shtet i kombit maqedonas, zanafilla e të cilit lidhej me kryengritjen e Ilindenit si dhe Republikën e Krushevës të vitit 1903, ndonëse në të nuk përmendej fare emërtimi Maqedoni.<sup>1861</sup>

Nga dokumentet që u aprovuan në Kuvend: Deklarata bazë e ASNOM-it,<sup>1862</sup> Manifesti në formën e një proklamate drejtuar popullit,<sup>1863</sup> vendimi për krijimin e gjuhës maqedonase (ndonëse gjuhësisht një dialekt bullgar) dhe shpalljen e saj gjuhë zyrtare me alfabeti cirilik të Vuk Karaxhiqit, del karakteri i shtetit dhe i kombit maqedonas.<sup>1864</sup>

Manifesti drejtuar kombit maqedon, siç thuhej i mbështetur mbi idenë e patriotizmit maqedonas që kishte krijuar shtetin e ri në bazë të traditave të Ilindenit dhe të Republikës së Krushevës, e ndërlidhte edhe me një thirrje drejtuar “Maqedonasve” në Greqi dhe Bullgari, që t’i bashkohen idesë së “rizgjimit maqedonas”, pra që të deklaroheshin maqedonase dhe në shtetet e tyre dhe atje të luftonin për të drejtat e mohuara kombëtare.<sup>1865</sup>

Në këtë aspekt, ASNOM-i i organizuar nën regjinë e komunistëve të Titos, paraqiste një kthesë të madhe ngaqë, jo vetë që refuzonte dhe mohonte karakterin etnik dhe gjuhësor bullgar të popullatës sllave në këtë pjesë, që si i tillë njihej nga pikëpamja historike dhe gjuhësore, por atë e zhvendoste nga një faktor krize midis vendeve ballkanike (Bullgarisë, Serbisë dhe Greqisë) dhe interesat e tyre hegjemoniste mbi një hapësirën gjeografike, që të shumtën përfshinte dy nga katër vilajete shqiptare (të Kosovës, Manastirit), në kuadër të Perandorisë Osmane, në një realitet jugosllav, në përbërje të federatës së re, si një republikë e barabartë të kombit sapo të shpallur maqedonas, midis gjashtë të tjerave. Misioni i tij

---

<sup>1860</sup> Христов, Александар: „Место и значувањето на АСНОМ во националната и државноправната историја на македонски народ“, Скопје, 1997.

<sup>1861</sup> Горги Цаца: „Уставофорниот карактер на првото заседање на АСНОМ“, Скопје, 1995.

<sup>1862</sup> Христов, Александар: „Место и значувањето на АСНОМ во националната и државноправната историја на македонски народ“, Скопје, 1997.

<sup>1863</sup> Горги Цаца: „Уставофорниот карактер на првото заседање на АСНОМ“, Скопје, 1995.

<sup>1864</sup> Димитрова, Евгени: „АСНОМ“, документи, Скопје, 1996.

<sup>1865</sup> Христов, Александар: „Место и значувањето на АСНОМ во националната и државноправната историја на македонски народ“, Скопје, 1997.

duhej që në një ambient të tillë “me shtypje klasore dhe nacionale” në të kaluarën, hegjemonizmin jugosllav ta zëvendësonte me “patriotizmin e ri jugosllav” mbi baza ideologjike, ku “barazia klasore” do të përmbyste klasën shtypëse dhe do të sillte në pushtet forcat e reja antifashiste, që do të jenë në gjendje jo vetëm t’i korrigojnë padrejtësisë e së kaluarës, por të ndërtojnë një shoqëri të barabartë mbi parimet e “vëllazërim-bashkimit të popujve”.

Por, në Deklaratën e ASNOM-it, gjuha e internacionalizmit proletar, formulën e njohur të barazisë e konvertoi te “rikthimi i Maqedonasve të mohuar në histori” dhe “të shtetit të tyre”. Kështu shpallja e shtetit të Maqedonisë quhet “e arritur historike e kombit maqedonas” në përputhje “me traditat e tij liridashëse”. Në këtë deklaratë nuk përmenden fare shqiptarët si pjesë e një etnie historike nga antikiteti. Bëhej fjalë vetëm për “qytetarët” që do të gëzonin të gjitha të drejtat demokratike.<sup>1866</sup>

Nga dokumentet tjera përcjellëse: Deklarata për organizimin e pushtetit popullor nëpërmes këshillave nacionalçlirimtarë dhe ato që lidhen me organizimin e aradheve partizane, theksohet çështja e rikthimit të “pushtetit maqedon” në viset “e çliruara” në Maqedoninë Perëndimore (Dibër, Gostivar, Tetovë), si dhe domosdoja që duhet t’i jepet “reklionit fashist” dhe bartësve të tyre, gjë që nënkuptonte qërimin e hesapeve me forcat nacionaliste dhe demokratike shqiptare, që nuk pajtoheshin me rikthimin e pushtetit sllavo-komunist.<sup>1867</sup>

Në Kuvendin e ASNOM-it, me shpalljen e Maqedonisë shtet të maqedonasve, Tito ia doli që ta shkëpusë Maqedoninë nga konceptet bullgaromëdha të krijuara nga Shën Stefani e këndeji si dhe pretendimet hegjemoniste në vazhdimësi nga Kriza Lindore. Po ashtu, ia doli që me krijimin e Maqedonisë, atë tashkëpusë edhe nga politika asimiluese e Serbisë dhe e popullatës së saj, e cila nga vitit 1912, kur ishte pushtuar nga Serbia, duke u kthyer në Banovinë të Vardarit, i ishte shuar emri Maqedoni, ndërsa sllavët e atjeshëm ishin trajtuar serbë.

Por, me ASNOM-in, Titoja ia doli që edhe shqiptarët etnikë, t’i përjashtojë nga pronësia shtetërore si dhe e drejta që të jenë të barabartë qoftë edhe në përputhje me doktrinën komuniste të “vëllazërim-bashkimit”. Kështu që, për shqiptarët e Kosovës dhe ata të Maqedonisë Perëndimore, shumë prej të cilëve kishin besuar se lufta antifashiste, së cilës i ishin bashkuar, do t’ua plotësonte idealet e barazisë, ku bënte pjesë edhe ajo e të drejtës historike për shtet të përbashkët,

---

<sup>1866</sup> Димирова, Евгени: АСНОМ, документи. Скопје, 2000 dhe Lita, Qerim: “*Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974*”, në gjashtë vëllime, Shkup, 2018, libri i parë: Qëndresa Antikomuniste.

<sup>1867</sup> Христов, Александар: „*Место и значувањето на АСНОМ во националната и државноправната историја на македонски народ*“, Скопје, 1997.

fitorja e revolucionit popullor si dhe realitetet që solli ajo, i kthehen në pakicë kombëtare nën pushtetin sllavo-komunist. Madje, me hipotekën e rëndë të “nacionalistëve dhe bashkëpunëtorëve të fashizmit” të manifestuar gjatë “Shqipërisë së Madhe”, që do t’u kthehet në barrë të dyfishtë shtypjeje në vitet në vijim.

Që të rumbullakohej modeli i Maqedonisë shtet kombëtar i maqedonasve në përbërje të federatës jugosllave, i shpallur në kuvendin e parë të ASNOM-it më 2 korrik 1944, i duhej edhe infrastruktura “demokratike” dhe ajo institucionale në përputhje me ecurinë që ndiqte Titoja dhe shtabi i tij i partiak që njëherësh drejtonte edhe luftën partizane në kuadër të aleancës antifashiste, ku ai, tashmë ishte kthyer në një lider të rëndësishëm të saj dhe për shumë çështje plotësonte hapësirën midis “bllokut” perëndimor dhe atij lindor. Meqë mbikëqyrte në tërësi luftën nacionalçlirimtare në Shqipëri, duke e kthyer në një vasale dhe, ia kishte dalë që edhe Dimitrovini ta kthente në një pasues të tij në raport me Stalinin, Titoja nxitoi që Serbisë ende gjithnjë “me telashe” në raport me çetnikët, me legjitimitimin e mëtutjeshëm të ASNOM-it në Maqedoni, t’ia qesë rrethin, që të pranojë Jugosllavinë e AVNOJ-it edhe “si interes të vetin nacional” prej nga ajo “mund ta ruante primatin edhe në shtetin komunist me kusht që të ndiqte kursin e Titos”.<sup>1868</sup>

“Izolimi” i Serbisë nga jugu, nëpërmes një kordoni ushtarak të vendosur në Maqedoni përbërë nga brigadat partizane jugosllave, ato bullgare dhe sovjetike, kishte rëndësi strategjike në njërin anë që t’u ndërpritej mundësia tërheqjes për në veri armatës gjermane F, e cila kërkonte që luginën e Vardarit dhe të Moravës ta shfrytëzonte për rigrupim në pjesën e Sremit për një “kundërofensive” në atë pjesë, dhe në tjetrën anë, t’i parandalohet çfarëdo mundësie Greqisë së reshtuar me aleatët për t’u përfshirë në pjesën jugore në përkrahje të forcave nacionaliste shqiptare, serbe dhe bullgare, që kërkonin të lidheshin me aleatët në kuadër të një fronti të ri antikomunist në këto pjesë, për ç’gjë britanikët ishin të interesuar.<sup>1869</sup>

Kështu, pasi që brigadat partizane jugosllave (kryesisht nga Mali i Zi dhe nga Serbia shumë prej tyre çetnikë të konvertur në partizanë pas marrëveshjes Tito-Shubashiq),<sup>1870</sup> ato të Shqipërisë, të shqiptarëve të Maqedonisë<sup>1871</sup> dhe të Ko-

---

<sup>1868</sup> Rreth Serbisë dhe rolit të saj në federatën e re Jugosllave të drejtuar nga Tito, shih intervistën e Vasa Çubrilloviqit (autorit të dy memorandumeve antishqiptare nga viti 1937 dhe 1944), dhënë magazinës “NIN” të Beogradi, maj, 1986, duke qenë kritik nga Memorandumi më i ri i Akademikëve Serbë të iniciuar nga Dobrica Qosiq, me ç’rast do të theksojë se Jugosllavia e Titos ishte në interes të popullit serb, se ajo, edhe në rrethanat ideologjike, u shkoi për shtati interesave serbe, dhe se, rrënimi i saj, do të jetë në dëm të popullit serb, ngaqë humb kornizën më të fuqishme gjeopolitike dhe gjeostrategjike për të qenë faktor rajonal.

<sup>1869</sup> Shih Dedijer, Vladimir: “*Novi prijelozni za biografiku Josipa Borza Tita*”, 1986.

<sup>1870</sup> Shih: Pirjevac, Jože: “*Tito i Drugovi*”, Zagreb, 2012, faqe 168.



sovës si dhe të Bullgarisë gjatë ofensivës së përbashkët tre mujore të ndihmuar edhe nga Armata e Kuqe të kenë fituar betejën kundër “forcave nacionaliste shqiptare” në Kosovë dhe Maqedoninë Perëndimore, me ç’rast do të ushtrohet një terror i paparë ndaj popullatës shqiptare, dhe në Shkup të kenë instaluar një infrastrukturë të fuqishme ushtarake, më 28 dhe 30 dhjetor 1944, në Shkup i mbajt Mbledhja e jashtëzakonshme e ASNOM-it, në të cilën mori pjesë bashkë-punëtori i ngushtë i Titos, Eduard Kardel, Dimitar Vllahov, Llazar Kolishevski si dhe përfaqësuesi bullgar, gjenerali Dobri Trepshev. Në këtë mbledhje, liderët jugosllavë bënë një demonstrim ushtarak drejt organizimit të mëtutjeshëm të infrastrukturë së vendosjes së “pushtetit popullor” në të gjitha nivelet me anën e këshillave vendore nacionalçlirimtare që duhej të merrnin pushtetin “nga baza”. Nga fjala e Kardelit del se “faza vendimtare e luftës antifashiste që duhej të mbyllej me fitoren e pashmangshme të frontit të përbashkët antifashist”, duhej të përcaktonte edhe karakterin e “pushtetit të ardhshëm popullor”, që si parakusht kishte “qërimin hesapeve me forcat nacionaliste, kuislingët dhe shërbëtorët tjerë të fashizmit”.<sup>1872</sup>

Kardeli theksoi se “miqësia e përbashkët midis partizanëve jugosllavë, atyre shqiptarë, bullgarë e ndihmuar nga Armata e Kuqe sovjetike ishte përcaktuese për rendin e ri shoqëror dhe politik që do të shfaqej”.<sup>1873</sup>

Kuvendi i ardhshëm i ASNOM-it, me të cilin filloi jetësimi i pushtetit komunist në Jugosllavinë e re sipas konceptit të AVNOJ-it, pra si republikë federative, u mbajt në Shkup, nga 14-16 prill 1945. Aty u mor vendimi për krijimin Qeverisë së Përkohshme të Republikës së Maqedonisë, kryetar i së cilës u zgjodh Llazar Kolishevski,<sup>1874</sup> një bashkëpunëtor i Titos nga plejada e intelektualëve

---

<sup>1871</sup> Krahas brigadave partizane nga Shqipëria, morën pjesë edhe Brigada 8 e Preshvës dhe e 12 partizane e Bujanovcit nga sektori i Kumanovës. Në Divizionin e Kumanovës me brigadën 18 vepronte edhe brigada II dhe III kosovare në rajonin e Preshevës. Në kuadër të Divizionit 48 të “Ushtrisë Nacional Çlirimtare të Maqedonisë” bënte pjesë edhe Brigada IV shqiptare, e formuar më 2 gusht 1944. Komandant i brigadës ishte Nafi Sulejmani, Qemal Agolli, komisar politik. Taip Taip i ishte shef i “OZN”-nas në Brigadë. Brigada IV shqiptare më 8 nëntor mori Strugën, duke lënë 35 të vrarë. Kjo brigadë mori pjesë në luftimet për Kërçovën, ku u ndesh me forcat e Ballit Kombëtar. Kjo brigadë, pasi mori pjesë në të gjitha luftimet kundër forcave nacionaliste shqiptare në Maqedoninë Perëndimore, në janar 1945, me emrin Brigada e Shtatë sulmuese, u dërgua në frontin e Sremit, ndërsa Maqedonia Perëndimore mbeti nën mbikëqyrjen e brigadave çetnike, të cilat, në emër të qëimit të hesapeve me “bashkëpunëtorët e armit, fashistët dhe kollob vazhduan terror ndaracionistëve”, ushtruan terror mbi popullatën shqiptare.

<sup>1872</sup> Pirjevac, Jože: „Tito i drugovi“, Zagreb, 2012, faqe 386-390.

<sup>1873</sup> Po aty si dhe Petranović, Brankov: “Tito i Staljin 1944-1946”, Jugoslovenski istorijski časopis, I, XXIII (1,2), 1988.

<sup>1874</sup> Llazar Kolishevski, i lindur në Manastir në vitin 1928, si fëmijë, me familjen ishte shpërngulur në Kragujevc të Serbisë ku kishte kryer gjimnazin. Në Kragujevc dhe më vonë Beograd kyçet në veprimtarinë komuniste. Në vitin 1935 zgjidhet anëtarët i PKJ-së së rrethit të Kragujevcit. Ndërsa në vitin 1941, delegat në Konferencën e Pestë të Partisë, ku zgjidhet në KQ të PKJ-së si delegat i Serbisë. Mbas kapitullimit të Jugo-

maqedonas të lidhur me Beogradin. Me këtë rast ASNOM-i u kthye në Kuvend Popullor të Republikës së Maqedonisë.

## MAQEDONIA NË FEDERATËN JUGOSLLAVE – PËRFITUESJA KRYESORE

Mund të thuhet lirisht se për Republikë e Maqedonisë, më shumë se për njësitë tjera federative, Jugosllavia e Titos, ishte e dobishme dhe e nevojshme madje edhe përfituesja kryesore nga themelimi e deri te shpërbërja e saj. Në kuadër të saj, një identiteti të kontestuar kombëtar, nëpërmes faktorëve politikë iu krijua platforma e duhur identifikuese me atë të shtetësisë, e përcjellë me në një zhvillim të gjithëmbarshtëm ndër më të fuqishmit në vend në aspektin kulturor, arsimor dhe atë ekonomik.

Megjithëqë në Kushtetutën e parë të Republikës së Maqedonisë, të aprovuar më 31 dhjetor 1946, në përputhje me teorinë e “demokracisë popullore” e parë nga aspekti klasor, bartës i sovranitetit shfaqej populli,<sup>1875</sup> formalisht shmangej përkufizimi “shtet i kombit maqedonas”, siç thuhej në dokumentet e ASNOM-it të vitit 1944 (deklaratën dhe manifestin),<sup>1876</sup> Maqedonia, faktikisht, do të përjetohet por edhe do të kuptohet si shtet i popullit maqedonas. Krahas definimit të popullit si kategori klasore, me ç’rast interpretimi politik përfshinte, si “punonjës” të gjithë qytetarët me të drejtat e tyre, ishte identiteti kulturor (gjuha maqedonase – gjuhë zyrtare), arsimit në maqedonisht, krijimtaria, shkenca si dhe simbolet që Maqedonisë ia jepnin karakterin e shtetit kombëtar, ndërsa maqedonasve epitelin e kombit shtetëror.

Nga pikëpamja kushtetuese, raportet klasore midis popullit punonjës si bartës i sovranitetit shtetëror, në këtë rast i maqedonasve, si dhe pakicave (shqiptarëve dhe të tjerëve), përkundër propagandës partiake dhe parullave ideologjike

---

sllavisë, me detyra partiake dërgohet në Maqedoninë e pushtuar nga bullgarët, ku edhe burgoset dhe dënohet me pushkatim, por më vonë i kthehet në burg të përjetshëm. Në burgjet bullgare do të qëndrojë deri në shtator të vitit 1944. Lirohet pas kapitullimit të Bullgarisë fashiste. Gjatë kohës së burgut, Tito e përdor për nevojat e Partisë Komuniste Jugosllave, duke e emëruar sekretar të Komitetit Krahinor të PKJ-së për Maqedoni. Si i burgosur do të zgjedhet delegat edhe në kuvendin e AVNOJ-it në Jajce më 29 nëntor 1943 dhe në kryesinë e Kuvendit të ASNOM-it më 2 gusht 1944! Në vitet e pesëdhjeta Titoja do ta kthejë prapë në Beograd, si përfaqësues i Maqedonisë në funksionet më të lartas partiake dhe shtetërore.

<sup>1875</sup> Reth aspektit klasor të sovranitetit të popullit dhe ndërlidhjes me nocionin komb dhe kombësi, që do të shfaqet në kushtetutën e vitit 1974, mbi të cilin u mbështet edhe parimi i vetëvendosjes së popujve deri te shkëputja, shih: Kardel, Eduard: “Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë”, Prishtinë, 1980.

<sup>1876</sup> Shih: Димитрова, Евгени: „АСНОМ“, документи, Скопје, 1996.

të përdoruar gjatë luftës “rreth barazisë së plotë kombëtare” e të ngjashme, të fabrikuar nga marrëveshjet “vëllazërore” midis komunistëve jugosllavë dhe atyre shqiptarë gjithnjë nën diktatin e Titos, së paku në dy dekadat e para të shtetit maqedonas, pasqyrojnë gjendjen faktike të shqiptarëve si pakicë, me ç’rast, “barazia” u nënshtrohej kritereve ideologjike, pra që edhe “kombëtarja” (përdorimi i gjuhës, shkollimi, informimi dhe të tjera) t’i nënshtrohej informimit - në nivelin e përkthimeve, ose në shërbim të frymës “së patriotizmit jugosllav”, gjë që rrudhej ose sipas rasteve edhe përjashtohej kultivimi i vlerave themelore kombëtare nga tradita dhe historia.

Ky diskurs (ndryshimi i tij) lidhet me dy zhvillime politike të kohës:

- atë të raporteve thuajse vëllazërore midis komunistëve jugosllavë dhe atyre shqiptarë në përputhje me marrëveshjet e luftës të Titos me Enver Hoxhën të vendosura mbi kriteret fanatike ideologjike dhe vazhdojnë deri në vitin 1949 kur do të shfaqet Rezoluta e Informbyrosë me të cilën Jugosllavia përjashtohet nga “familja” komuniste e drejtuar nga Stalini dhe,

- atë nga viti 1949 e deri në vitin 1963, kur fryma e internacionalizmit proletar dhe ato që karakterizonin raportet politike dhe shtetërore jugosllave-shqiptare thuajse në tërësi i lihen në dispozicion unitarizmit serb, që në emër të ideologjisë t’u rikthehet formulave të njohura anti-shqiptare, të qërimit të hesapeve me kulturën, historinë si dhe qenien e tyre etnike, duke kthyer metodat e njohura antishqiptare të Jugosllavisë së Versajës: kolonizimin dhe shpërnguljen.

Megjithatë, raportet midis maqedonasve dhe shqiptarëve në Maqedoni në periudhën e parë 1944-1949, pra atë të bashkëpunimit vëllazëror midis komunistëve jugosllavë dhe atyre shqiptarë të vendosura gjatë luftës nuk kanë qenë shpërputhëse dhe aq diskriminuese, siç do të ndodhë më vonë. Kriteri klasor, për të gjithë nënkuptonte fazën e “emancipimit shoqëror dhe politik”, që nënkuptonte “kthesat pozitive” në shkollim, edukim, punësim, me ç’rast “shoqërisë së re” dhe “njeriut të ri” i duheshin thyer disa shabllone nga e kaluara: barazinë gjinore dhe atë fetare. Barazia gjinore kërkonte çlirimin e femrës nga normat fetare (heqja e ferexhesë) si dhe ndalimi me ligj i martesës me shumë gra që lejonte sheriatin. Edukimi i ri, po ashtu, nënkuptonte shkollimin e barabartë të fëmijëve (veçmas femrave) si dhe përfshirjen e tyre në jetën shoqërore dhe politike madje, duke u përfaqësuar në organet e pushtetit po edhe në administratë.

Instalimi i pushtetit popullor, siç quhej pushteti komunist, mori përsipër këto veprime dhe mund të thuhet se vitet në 1945-1949, krahas fushatës së “qërimit të hesapeve me forcat reaksionare” (të tilla konsideroheshin forcat patriotike që luftonin kundër rikthimit të pushtetit sllavo-komunist), me ç’rast, siç u pa, në emër të “shoqërisë së re pa klasa” u zhvillua një fushatë antikombëtare e përmasave të gjëra, rrodhën edhe “aksionet emancipuese” që u pasqyruan me fillimin e hapjes së shkollave fillore në gjuhën shqipe, me fillimin e informimit në gjuhën shqipe (ndonëse të përkthyer nga serbokroatishtja), si dhe me përfshirjen e kuadrove të caktuara shqiptare në radhët e administratës, policisë dhe ushtrisë dhe në përfaqësimin politik të vendit.

Në këtë aspekt, faktori më i rëndësishëm shfaqej arsimimi, që lidhej me hajen e shkollave shqipe. Kjo në të vërtetë ishte “nyja” e besimit dhe mirëbesimit shoqëror dhe politik me pushtetin e ri popullor në përputhje me premtimet e dhëna gjatë luftës që u ishin bërë shqiptarëve për të marrë pjesë në frontin e përbashkët antifashist. Te kjo çështje, komunistët shqiptarë do të tregohen konsekuent dhe nga komunistët jugosllavë kërkuan që të mbajnë fjalën, meqë shkollimi dhe emancipimi i shqiptarëve në Maqedoni dhe Kosovë, qoftë edhe i karakterit ideologjik, ishte edhe interes i përgjithshëm dhe aty me të cilën dallohej “e reja” nga “e vjetra” - nga e kaluara shtypëse jugosllave. Pos aspektit “emancipues” mbi konceptet ideologjike-klasore të modelit sovjetik “për barazi”, plotësimi qoftë elementar i të drejtave për arsimim në gjuhën amtare, parandalonte edhe “reaksionin” që mbi këtë faktor dominues të organizonte “kryengritje popullore”, që mund të përkraheshin nga “forcat imperialiste” gjithnjë vepruese nga jashtë.

Në përputhje me këto qëndrime, Qeveria e Maqedonisë solli vendimin për hapjen e shkollave fillore me mësim në katër gjuhë: maqedonisht, shqip, turqisht dhe serbokroatisht. Kështu, në Shkup, më 1 dhjetor 1944, u hap shkolla e parë shqipe “Liria”,<sup>1877</sup> edhe pse dhoma e arsimit pranë qytetit, nuk dëshironte të jepte leje për hapjen e shkollës shqipe në këtë qytet me arsyetimin se “në Shkup nuk ka shqiptarë, por vetëm turq, andaj nuk mund të hapet shkolla shqipe, por vetëm turke”.<sup>1878</sup>

Përkundër këtyre vështirësive dhe pengesave administrative, që edhe kur jepeshin leje për shkollat shqipe, në to kur thuhej “meshkujt mysliman mund të

---

<sup>1877</sup> Mësuesit e parë të shkollës “Liria” në Shkup ishin Azem Marana dhe Hasan Bislimi. Shi: Lita, Qerim: “KQ i NDSH-së dhe Azem Marana”, Shkup, 2011, faqe 213-233.

<sup>1878</sup> Lita, Qerim: “Territoret Lindore shqiptare 1912-1960”, Shkup, 2016, faqe 149.

regjistrohen në shkollën shqipe, ndërsa vajzat vetëm në atë turke”,<sup>1879</sup> theksohej antishqiptarizmi perfid, në vitin shkollor 1944/45, në këtë shkollë u regjistruan gjithsej 365 nxënës të shpërndarë në gjashtë paralele.<sup>1880</sup>

Edhe pse pati vështirësi të shumta, siç ishin ato që u shfaqen në Shkup, gjatë vitit shkollor 1944/45, në 50 shkolla fillore nga 971 sa u hapen në Maqedoni, ku punonin gjithsej 104 mësues, u përfshinë 3.975 nxënës shqiptarë në mësimin në gjuhën shqipe, nga 85.100 sa pati në mbarë vendin, ose 4%.<sup>1881</sup>

Në vitin në vijim, numri i shkollave në gjuhën shqipe në Maqedoni zgjerohet në 157 sosh nga 905 sa ishin në gjuhën maqedonase, ndërsa numri i nxënësve shkoi në 12.359.

Por, “vërshimi” i shkollave shqipe, në vitet në vijim, do të parandalohet me “pretekstet” e veprimtarisë “armiçësore” të arsimtarëve shqiptarë, të përfshirë në veprimtarinë e Organizatës Nacional Demokratike Shqiptare, shumë prej të cilëve u arrestuan dhe u dënuan.<sup>1882</sup>

Pos dënimit të mësuesve në procesin politik kundër NDSH-së, që u pasqyrua me frenimin e hapjes së shkollave shqipe me pretekstet “e mungesës së mësuesve”, shkollimi katërvjeçar në gjuhën shqipe në Maqedoni do t’i vijë edhe një grusht tjetër i rëndë nga pushteti maqedonas, nga një vendim i Ministrisë së Arsimit i lëshuar në gusht 1946, në të cilin thuhej “Në plan-programet mësimore për shkollat e pakicave nga viti i kaluar qëndron se në lëndët e historisë dhe gjeografisë në ato shkolla do të mësohet historia dhe gjeografia e Jugosllavisë me historinë dhe gjeografinë e popujve që u takojnë pakicat. Kjo duhet të përmirësohet në atë mënyrë që edhe te shkollat e pakicave do të mësohet vetëm historia dhe gjeografia e Jugosllavisë, njësoj si te shkollat maqedonase”.<sup>1883</sup>

Krahas arsimit në gjuhën shqipe me hapjen e shkollave fillore në Maqedoni nga viti shkollor 1944/45, në kuadër të emancipimit klasor, përfshihej edhe kultura shqiptare në Maqedoni, si një faktor i barazisë së premtuar gjatë luftës antifashiste. Në gusht të vitit 1945, Byroja Politike e KQ të PKM-së, nxori urdhëresën me të cilën kërkohet që organizatat e Frontit të formohen këshillat kulturore-arsimore, ndërsa në to seksione zgjeruara kulturo-arsimore të pakicave.<sup>1884</sup>

---

<sup>1879</sup>По ату, citim i dokumentit: ДАРМ (Државни Архив Републике Македоније) – 1.1101.6.12/523-578.

<sup>1880</sup> По ату.

<sup>1881</sup> По ату, faqe 150.

<sup>1882</sup> По ату.

<sup>1883</sup> Lita, Qerim: “Territoret Lindore shqiptare 1920-1960”, Shkup, 2016, dok: ДАРМ.1.170.13.53/345-350.

<sup>1884</sup> По ату, dok: ДАРМ.1.427. 1. 65/281-285.

Në përputhje me këtë dekret partiak, në mesin e muajit dhjetor 1945, gjithnjë në kuadër të Frontit Popullor, formohet “Komisioni Kulturo-Arsimor Shqiptar”,<sup>1885</sup> prej pesë degëve të veçanta: Dega për Agjitim Gojor, Dega për Shtypin dhe Propagandën, Dega e Kulturës dhe Arsimit, Dega e Ligjëratave dhe Dega Tekniko-Organizative.<sup>1886</sup>

Nga të dhënat e kohës del se puna e “Komisionit Kulturor-Arsimor Shqiptar”, kishte qenë e përqendruar dhe shumë e suksesshme, ngaqë brenda një kohe të shkurtë degët e saj ishin përhapur në të gjitha viset të banuara me shqiptarë, veçmas në ato të rëndësishme për nga tradita kulturore (Dibra, Tetova, Gostivari), me ç’rast, krahas projekteve për hulumtimin dhe mbledhjen e trashëgimisë folklorike, kishte filluar organizimi i manifestimeve kulturore në të gjitha trevat shqiptare si dhe i atyre sportive të rinisë shqiptare.<sup>1887</sup>

Në kuadër të aktiviteteve kulturore, te një rëndësie të veçantë ishte edhe shtypi në gjuhën shqipe. Me direktivat e Parisë u themelua gazeta e parë në gjuhën shqipe “Flaka e Vllazërimit”. Kjo gazetë, që nisi të dalë një herë në muaj, në formën e një buletini informativ, të shumtën me informata të përkthyer, megjithatë afroi rreth vetës intelektualë dhe krijues, që nuk do të vonojë, dhe shumë prej tyre, do të shkruajnë vepra të rëndësishme letrare, me të cilat u pasua fondi i gjithëmbarshtëm i letërsisë shqiptare.

Ndaj, me të drejtë, mund të thuhet se kultura shqiptare në Maqedoni, përkundër kriterëve klasorë dhe shemave ideologjike, përkundër vështirësive me të cilat u ballafaqua kur po i vinte themelet e veta, në saje të punës së madhe që bërë Komisioni Kulturor-Arsimor Shqiptar gjatë tri vjetëve të para, pak a shumë, mbeti në binarët identitetit shpirtëror.

Zhvillimi i dytë, nga viti 1949-1963, pra nga prishja e marrëdhënieve politike të Titos me Stalinin si dhe ndërprerja e bashkëpunimit të plotë midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë si dhe shfaqje së kufirit të hekurt midis shqiptarëve në të dy anët e kufirit, në Maqedoni pati ndikim negativ për shqiptarët në Maqedoni, ngaqë i dha shkas politikës antishqiptare të Beogradit, që ta ndikojë edhe kon-

---

<sup>1885</sup> Komisioni Kulturor-Arsimor-Shqiptar themelohet në dhjetor 1945, me iniciativën e intelektualëve të atëherëshëm: Pjetro Janura, Lutfi Rusi, Kamber Xharia, Mahmut Dumani, Azem Marana, Osman Miftari, Murteza Peza, Jonuz Balla, Ali Shehu e të tjerë. Agitprop-i-shqiptar për të gjithë Maqedoninë, siç u quajt, kishte shtruar detyrat e veta, ndër të cilat ishin: botimi i broshurave dhe i librave në gjuhën shqipe, hapjen e një numri sa më të madh të kurseve klundëranalfabetike, mbledhja e materialit për folklorin shqiptar e të tjera.

<sup>1886</sup> Po aty, faqe 154, dok: ДАРМ.Ф. Народен Фронт. К. 4. Док. 61/85/87.

<sup>1887</sup> Në kuadër të aktiviteteve të shumta që pati dega e Shkupit e Komisionit Kulturo-Arsimor Shqiptar, përfshihet edhe themelimi i Shoqërisë sportive të rinisë shqiptare “Luboten” në Shkup, në kuadër të cilës përfshihej futbollu, mundja, skijimi, noti e të tjera. Sekretar i kësaj shoqërie ishte Azem Marana.

ceptin klasor dhe ideologjik të afirmimit të pakicave kombëtare, i cili ishte vendosur menjëherë pas luftës në saje të marrëveshjeve ideologjike midis Titos dhe Enver Hoxhës në planin ushtarak (futja e brigadave shqiptare në Kosovë dhe Maqedoni në tetor 1944) si dhe të planeve të tjera, siç ishin ato për unionin e përbashkët ballkanik në formën e Federatës midis Jugosllavisë, Bullgarisë, Shqipërisë dhe projekteve të tjera ndërshtetërore midis Beogradit dhe Tiranës, sidomos për “unionin ekonomik” midis dy shteteve, që kishte filluar të funksiononte në fushën e ekonomisë dhe të financave ku Shqipëria gjithnjë e më shumë po futej në varësi të Jugosllavisë.

Serbia, e cila e kishte aneksuar Kosovën në Kuvendin e Prizrenit, në korrik 1945, duke e kthyer në një “oblast”,<sup>1888</sup> që bashkë me Vojvodinën si autonomi, e kishte peshqesh nga Titoja për ta pranuar Jugosllavinë e ANVOJ-it<sup>1889</sup> dhe, në përputhje me këtë “të drejtë”, duke shfrytëzuar shpërthimin “e kundërrevolucionit në Kosovë” në nëntor 1944 (anatemë kjo rezistencës kombëtare shqiptare kundër ripushtimit sllavo-komunist të Kosovës nga partizanët jugosllavë dhe ata shqiptar), kishte filluar një fushatë të ashpër kundër identitetit etnik dhe kulturor shqiptar në Kosovë, nuk kishte qenë e kënaqur me “porcionin” e të drejtave kulturore dhe arsimore të shqiptarëve në Maqedoni, sidomos me veprimtarinë kulturore të Komisionit Kulturor-Arsimor Shqiptarë, që edhe në kuadër të konceptit klasor të barazisë, pak a shumë, u kthehej rrënjëve identitare, me që kjo, pos tjerash krijonte “standardet e dyfishta” të trajtimit të pakicës shqiptare në Jugosllavi, ku Maqedonia i avanconte, ndërsa Serbia i ngushtonte dhe i luftonte me pretekste të ndryshme shumë prej tyre si receta të dala nga Elaborati i Çubrilloviqit i tetorit 1944, ku lufta antifashiste duhej të shfrytëzohej për qërimin e hesapeve me “pakicat” (në radhë të parë me “kuislingët” gjermanët në Vojvodinë “folskdojçerat”, po edhe me hungarezët dhe shqiptarët “si bashkëpunëtorë të Gjermanisë fashiste”).<sup>1890</sup>

Ndonëse në Beograd do të ketë reagime të heshtura rreth “disa teprive” në Shkup në raport me “të drejtat nacionale të shqiptarëve” në dëm “të vëllazërim-bashkimit”, si dhe pasojave të tyre “negative në Kosovë”,<sup>1891</sup> megjithatë sa ishin marrëdhëniet e mira midis Beogradit dhe Tiranës, Titoja nuk lejonte me asgjë që

---

<sup>1888</sup> Buxhovi, Jusuf: “Kosova” IV, Prishtinë, 2015, faqe 351-355.

<sup>1889</sup> Shih gjerësisht Pirjevac, Jože: “Tito i Drugovi”, Zagreb, 2012, faqe 162-168 dhe Ćivals, Milova: „Tito. Eine kritische Biographie“, Molden, Wien, 1980 dhe „Kako je stvarana Titova karizma“, Slobodna Dalmacija, 22.10.1989.

<sup>1890</sup> Reth Memorandumit të Çubrilloviqit të tetorit 1944 shih Buxhovi, Jusuf: “Kosova” IV, Prishtinë, 2015, faqe 348-351.

<sup>1891</sup> Shih: Đaković, Spasoje: “Kjniga o Kosovu”, Prishtinë, 1982.

“recetat” serbe të Kosovës për të cilat ai kishte dijeni<sup>1892</sup> të shtriheshin në Maqedoni. Jo pse në Tiranë do të haste në ndonjë reagim për këtë, siç nuk ndodhte as për Kosovën, por pse e dinte se “mirëqenia” kulturore dhe shoqërore e shqiptarëve në Maqedoni mund të kishte ndikime pikërisht në drejtim të Shqipërisë, që ajo edhe më tepër t’i afrohej Jugosllavisë dhe të shkrihej në të, siç parashihej.<sup>1893</sup>

Krahas këtij supozimi, ka edhe faktorë të tjerë, që arsyetojnë qëndrimin e Titos që në Maqedoni arsimimi dhe ngritja kulturore e shqiptarëve të kishte tretmanin që kishte gjatë marrëdhënieve të mira me Shqipërinë e Enver Hoxhës, që ndonëse binin ndesh me konceptet e Beogradit që ata të shiheshin të lidhur me “identitetin turk” dhe me “mentalitetin oriental” (sidomos te femrat) në mënyrë që të krijohej një shkëputje identitare midis shqiptarëve të Kosovës dhe atyre të Maqedonisë deri në atë masë sa ato të dukeshin “të ndryshme”, mund të ishin të “kalkuluar” dhe të “kovertueshëm” për “situata të veçanta” në kursin e tij shpesh “të paparashikueshëm” politik në raport me planet e tij afatgjatë, të “pykave”, që ai i përdorte për qëllime të caktuara politike midis serbëve dhe maqedonasve, midis shqiptarëve dhe serbëve, po edhe kroatëve ndaj serbëve dhe anasjelltas?<sup>1894</sup>

## MAQEDONIA DHE KTHIMI I SAJ NË EPIQENDËR TË SHPËRNGULJES SË SHQIPTARËVE PËR NË TURQI

Përkundër fakteve se Titoja asokohe në Maqedoni e riktheu kartën nacionale për qëllime të caktuara politike (krijimin e kombit maqedonas, që nuk njihej gjatë mbretërisë jugosllave si dhe njohjen e kombësisë shqiptare, së cilës gjatë mbretërisë jugosllave i njihej vetëm identitetit fetar “si mysliman”), gjë që në këtë aspekt është fare e natyrshme që te faktori shqiptarë ka parë mundësinë e vetme të ruajtjes së baraspeshës politike të saj, megjithatë, të dhënat dëshmojnë se nga

---

<sup>1892</sup>Đilas, Milovan: „Tito. Eine Kritische Biographie“, 1980.

<sup>1893</sup> Shih: Horvat, Branko: “Kosovsko Pitanje”, 1988 dhe Meir, Viktor: “Jugoslawiens Erben”, München, 2001, faqe 118-129.

<sup>1894</sup> Rreth “potezave të paparashikueshëm” të Titos në formë të “pykave politike”, Milova Gjillas, bashkëpunëtor i ngushtë i Titos gjatë luftës e më vonë kundërshtar i ashpër për ç’gjë edhe do të dënohet me burg, zë ngojë edhe ato të maqedonasve me shqiptarët në Maqedoni gjatë raporteve të mira Shqipëri-Jugosllavi deri në vitin 1949 si dhe raporteve “të veçanta” politike serbo-Maqedonase, që kanë luajtur rëndësi në disa planifikime të tij të njohura dhe të panjohura me Enverin, Dimitrovën dhe madje Stalinin, mbi të cilat ka ndërtuar strategjinë e mbajtjes në këmbë të Jugosllavisë së AVNOJ-it, si një model që prej Gjillasit quhet “përkohësisht i suksesshëm”, por pa perspektivë historike, ngaqë nuk ishte në gjendje të eliminonte e as të pajtonte kontradiktat midis shqiptarëve dhe sllavëve (serbëve dhe maqedonasve), meqë ato mbështeten në eliminim të njëri-tjetrit dhe jo në barazi, shih: Đilas, Milovan: „Tito. Eine kritische Biographie“, Molden, Wien, 1980.



viti 1949 e deri në vitin 1963, në Maqedoni do të rikthehet shumëçka e politikës antishqiptare: nga programet hegjemoniste serbe midis dy luftërave botërore, sidomos me rikthimin e shpërnguljes së shqiptarëve për në Turqi në formën e politikës zyrtare shtetërore, të cilën më së miri e pasqyron Marrëveshja gjentelmene Tito-Kyprili në vitin 1953, ndonëse ajo kishte filluar edhe më parë.<sup>1895</sup>

Për ndryshim nga marrëveshja e parë jugosllave-turke e vitit 1938, ku Shkupi, me praninë e Konsullatës Turke dhe fondet e majme nga Ankaraja, luante rolin e mekanizmit kryesor “administrativ-teknik” prej nga fitonte dritën e gjelbër shpërngulja masive, këtë herë, Maqedonia dhe Shkupi si kryeqendër e saj, ktheheshin në epiqendër politike-shtetëror të këtij procesi, ngaqë marrja e vizës për shpërngulje për në Turqi kushtëzohej me deklarin “turk”, që kapërcente nëpër procedura e konvertimi nga “mysliman” në “turk”, që ligjërisht mundësohej vetëm në Maqedonia brenda një afati të shkurtër, pa marrë parasysh deklarinet e mëparshme. Kështu, krahas shqiptarëve të Maqedonisë, të cilëve u mjaftonte vetëm një deklarata nga Bashkësia Islame e përkatësisë fetare “si myslimanë” për t’u kthyer në “turq”, pa kurrfarë vështirësish kjo u mundësohej, edhe qytetarëve shqiptarë nga Kosova, Mali Zi, Sanxhaku dhe Bosnja e Hercegovina. Të tillëve, u mjaftonte paraqitja formale e një vendqëndrimin qoftë edhe të përkohshëm në Maqedoni, që brenda një muaji, me procedurë të shpejtuar të fitonin përkatësinë kombëtare “turke”!<sup>1896</sup>

Krahas faktorëve ideologjikë (prishjes me Stalinin dhe Shqipërinë) që ndikuan rikthimin e politikës antishqiptare me anën e shpërnguljes së organizuar shtetërore për në Turqi dhe madje edhe e përshpejtuan atë, shfaqen edhe ata gjeopolitikë, që lidhen me kthimin e Turqisë në shtyllë të NATO-s, dhe të afrimit të Jugosllavisë me Turqinë pas ngritjes së marrëdhënieve diplomatike në vitin 1951 në nivel të ambasadave, zhvillim ky që hapte udhën afrisë së mëtutjeshme të Jugosllavisë me NATO-n. Në këtë konfigurim interesash, zënia e hapësirës “neutrale” midis dy blloqeve antagonistë duhej ta amortizonte disi “luftën e ftohtë”, gjë që raportet e mira me Turqinë drejtpërdrejt e determinonin këtë rol. Ndaj, ishte e pritshme që në pokerin e ri ballkanik të drejtuar nga Titoja dhe perfiditeti i tij politik në raport me koniunkturat më të larta botërore, të përfillëshin edhe interesat e Turqisë në të, ku shpërngulja, në përputhje me konventat e nënshkruara në vitin 1938 midis Ankarasë dhe Beogradit, shfaqej si kërkesë prioritare e thek-

---

<sup>1895</sup> Rreth konventës jugosllave-turke të vitit 1938 si dhe procesit të shpërnguljes së shqiptarëve për në Turqi, shih: Buxhovi, Jusuf: “Kosova” IV, Prishtinë, 2015, faqe 228-235.

<sup>1896</sup> Lita, Qerim: “Territoret lindore shqiptare”, Shkup, 2016, faqe 171-188.

suar nga pala turke. Madje, përmirësimi i marrëdhënieve politike dhe diplomatike midis dy vendeve, nga fillimet e vitit 1951, ishte mbështetur mbi pajtimin e dyanshëm të dy vendeve, që asaj t'i lidheshin binarët e shkëputur në prag të Luftës së Dytë Botërore me anën “e veprimeve të përbashkëta”.

Kështu, klima e re e bashkëpunimit politik midis dy vendeve, vuri në vepër segmente të caktuara të shërbimeve të shtetit jugosllav të nivelit federativ dhe atij republikan, që pa ndonjë zhurmë, e gjitha të fillohet me anën e futjes së “misionarëve” të ndryshëm në këtë punë, ku “Bashkësia Fetare Islame” – mbrojtëse e “identitetit islam” në Maqedoni, që nga ana e saj shfaqej edhe si “etni islame”, së cilës “duhej dhënë përparësi në raport me deklaratimet me mjegullta kombëtare”, kishte një pozitë kyçe.<sup>1897</sup>

Përkrahësit e kthimit të shpërnguljes, jo rastësisht iu kthyen “Bashkësisë Fetare Islame” në Maqedoni, ngaqë ajo, edhe gjatë shpërnguljes së parë me marrëveshjen jugosllave-turke të vitit 1938, kishte qenë palë vendimtare në këtë proces, ngaqë me marrëveshje, procedura e marrjes së lejes për shpërngulje nga komisioni shtetëror jugosllav, jepej vetëm pasi që “Bashkësia Fetare Islame” në Shkup të lëshojë vërtetimin se pretendenti për shpërngulje ishte “mysliman”. Pra, paraf i “Bashkësisë Islame”, pos që i jepte dritën e gjelbër shpërnguljes për në Turqi, njëherësh i shërbente “si alibi” qeverisë Jugosllave se shpërngulja përfshinte vetëm besimtarët myslimanë si pjesë e të drejtës së tyre për të jetuar në vendin ku ata ruajnë identitetin e tyre. Në këtë hesap, gjithsesi se edhe “Bashkësia Fetare Islame”, ndjehej mirë, në shërbim të një misioni “të shenjtë”, që besimtarët myslimanë të jetojnë të bashkuar në shtetin islam.

Në rrethanat e reja, “Bashkësia Fetare Islame” në Maqedoni, nuk luante me vetëm rolin e parafuesit të fundit drejt shpërnguljes. Këtë herë “misioni” i saj, nuk mbyllej te çështja e “identitetit fetar mysliman”, siç parashihte marrëveshja e vitit 1938, por shkonte të ato të propagandës politike, me ç'rast përkatësia myslimane zbërthehej me deklarin kombëtar turk. Ndonëse klerikët myslimanë liroheshin nga përfshirja në çfarëdo procedure ligjore me të cilin do të zyrtarizohej përfshirja e tyre në këtë veprimtari, megjithatë, ata mbeteshin pjesë e rëndësishme “shpirtërore” e kësaj propagande, sado që do të ketë edhe klerikë myslimanë

---

<sup>1897</sup> Shih: dokument: ДАРМ.1.427.29.137/673-690 te Lita, Qerim: “Territoret Lindore shqiptare 1920-1960”, Shkup, 2016, faqe, 173.

që jo vetëm nuk do të përfshihen në këtë veprimtari, por edhe do ta kundërshtojnë atë, për ç'gjë edhe do të dënohen nga shteti.<sup>1898</sup>

Pra, me marrëveshjen e re midis dy shteteve që edhe më tutje mbetej “interne” (deri në vitin 1958), si parakusht që të fitohej e drejta e shpërnguljes, shfaqej deklarimi kombëtar turk, deklarim ky që ligjërisht ishte në kompetencë të shtetit (Komisionit Shtetëror për Shpërngulje në nivel federativ), por që për të ardhur deri te forma zyrtare, i duhej klima e përshtatshme shoqërore dhe politike, në radhë të parë, ajo e misionarizmit fetar, me ç'rast, “e drejta” për deklarim “të lirë” si turq, ndërli dhej me “identitetin fetar” mysliman, të cilin “Bashkësia Fetare Islame” e kishte theksuar vazhdimisht dhe kishte ngritur akuza ndaj “nacionalizmit shqiptar”, që kishte ndikuar që besimtarët mysliman të përcaktohen kombëtarisht shqiptarë në dëm të faktorit turk.<sup>1899</sup>

Në këtë mision, por gjithnjë në përputhje me “të drejtën që turqve t'u mundësohet deklarimi i lirë në përputhje me identitetin e tyre, ku natyrisht se besimi islam luante “rol vendimtar”, ishin përfshirë edhe zyrtarët turq dhe misionarët e ndryshëm nga Turqia, të cilët, krahas vizitave zyrtare-diplomatike vendbanimeve shqiptare në Maqedoni, ku propagonin haptas “ringjalljen e elementit turk në Maqedoni”, shfaqeshin edhe gjoja mysafirë, që vizitonin “kushërinjtë” dhe farefisin. Edhe ata bënë propagandë të hapur për shpërnguljen për në Turqi, ku i pret një “jetë e mirë”. Por, që kjo të bëhej realitet, ata duhej vetë të kërkonin nga zyrtarët në Maqedoni kjo “e drejtë” t'u mundësohej sa më parë me anën e shpërnguljes së organizuar.<sup>1900</sup>

Natyrisht se i gjithë marifeti i shfrytëzimit “të drejtës” për t'u shpërngulur për në Turqi varej nga deklarimi “turk”, përcaktim ky që tashmë, siç u pa, mun-

---

<sup>1898</sup> Më gjerësisht rreth qëndrimit të Bashkësisë Islame rreth shpërnguljes si dhe veprimtarisë së disa klerikëve mysliman në Maqedoni kundër shpërnguljes së shqiptarëve për në Turqi si dhe proceseve gjyqësore kundër tyre, shih Lita Qerim: “Territoret Lindore Shqiptare 1912-1960”, Shkup, 2016, faqe 171-179 si dhe te “Problemi shqiptar në RP (S) të Maqedonisë 1944-1974”, Përmbledhje dokumentesh, libri i dytë (Procesi i shpërnguljes), Shkup 2018.

<sup>1899</sup> Po aty.

<sup>1900</sup> Strategjia e përbashkët propaganduese për shpërnguljen për në Turqi midis zyrtarëve dhe diplomatëve turqë dhe atyre jugosllavë fillon gjatë vitit 1951. Organizator kryesor i tyre ishte ambasadori turk në Beograd, Fuad Kyprili. Kyprili inicioi ripërtëritjen e konventës së vitit 1938, me “modalitete të reja”, pra të “modifikimit” të kategorisë fetare “mysliman” në atë “turk”, të pranuar në Maqedoni dhe Kosovë si pakicë kombëtare, ku parashiheshin vizitat e diplomatëve dhe misionarëve turq në vendbanimet shqiptare në Maqedoni, ku mund të rekrutoheshin edhe misionarë për shpërngulje. Këtë e vërteton edhe një material i Byrosë Politike të KQ të LK të Maqedonisë i hartur enkas për shkaqet e shpërnguljes, ku pranohet roli i propagandës dhe misionarëve turq nëpër vendbanimet shqiptare si dhe joshja e qyetarëve me “jetën e mirë në Turqi”. (Shih: ДАРМ.1.427.60.7/116-129, te Lita, Qerim “Territoret Lindore shqiptare 1920-1960”, Shkup, 2016, faqe 172.)

dësohej në saje të politikës perfide që deklarimi i deridjeshëm “mysliman” (gjatë mbretërisë jugosllave i vetmi i mundshëm për shqiptarët etnik), të zëvendësohej me përcaktim “kombëtar turk”. Ky “modifikim” kishte rëndësi të dyfishtë për realitetet politike në Maqedoni, që përcaktoheshin edhe nga ato demografike, por edhe për Serbinë dhe raportet e saj me Kosovën dhe faktorin shqiptar në të, ku vlerësohej se, në rrethanat e reja, një pjesë e mirë e shqiptarëve në Maqedoni dhe Kosovë, fushatën e represionit do ta shfrytëzojnë për t’u shpërngulur për në Turqi.

Krahas mundësive për shpërngulje, deklarimi në “turq”, në Maqedoni, lidhej edhe me privilegje të caktuara në jetën shoqërore, politike po edhe atë ekonomike, ngaqë mundësonte përherë regjistrim nëpër shkolla me mësim në gjuhën turke, ku siguroheshin edhe burse për fëmijët jashtë qytetit. Po ashtu, deklarimi “turk” hapte dyert edhe për punësim jashtë “listave diferencuese”, dhe filtrave të tjerë partiak dhe policorë, që vlenin për shqiptarët. Për pjesëtarët “turq” ishin të hapur vende në administratë shtetërore, polici dhe gjyqësor. Të tillë ndërtonin shpejt edhe karrierë politike, gjë që e gjitha fliste për një politikë të hapur antishqiptare, që bëhej në emër të rikthimit të “identitetit nacional turk” në përputhje me “gjendjen reale”, që për zyrtarët maqedonas dhe jugosllavë, ishte penguar nga “nacionalizmi shqiptar”, i cili kishte imponuar shqiptarizmin edhe aty ku nuk ishte!

Për t’u “dëshmuar” kjo, pra veprimi “i nacionalistëve shqiptarë” ndaj popullatës turke dhe shfrytëzimit të të drejtave të tyre, shërbyen disa procese të montuara politike ndaj arsimitarëve dhe veprimtarëve shqiptarë nëpër qytete të ndryshme, me ç’rast ata u akuzuan dhe u dënuan për “propagandë kundër shkollave në gjuhën turke”.<sup>1901</sup>

Se rrudhja e arsimit në gjuhën shqipe dhe hapja e mëtutjeshme shkollave në gjuhën turke tashmë ishte kthyer në një program shtetëror që vinte nga organet partiake dëshmohej nga qëndrimet e Byrosë Politike, siç thuhej “lidhur me problemet politike, ekonomike dhe organizative në territoret ku shqiptarët përbënin shumicë absolute të popullatës.” Në to fillimisht ftoheshin organizatat partiake dhe ato masive të rretheve që të punonin “në përmbysjen e tendencave nacionalshoveniste”, ku në mënyrë të veçantë fokusohej arsimit në gjuhën shqipe “si gjenerator i ideve shqiptaro-mëdha”, me ç’rast gishti drejtohet nga Shqipëria e Enver Hoxhës si dhe “diversantët” shqiptarë që futeshin në këto pjesë.<sup>1902</sup>

Me këtë rast harrohej që ishin pikërisht partizanët e Enver Hoxhës, ata që para tri-katër vitesh, në bashkëpunim me partizanët jugosllavë dhe bullgarë kishin

---

<sup>1901</sup> Po aty.

<sup>1902</sup> ДАРМ.1.427.27.59/331-340.

ndihmuar “çlirimin” nga “Shqipëria e Madhe” dhe ripushtimin sllavo-komunist, që për çmim pati likuidimin e elitës nacionaliste shqiptare dhe sjelljen në pushtet të komunistëve.

Si “terapi” për t’u çrrënjësuar “indoktrinimi shqiptaromadh”, Byroja Politike urdhëronte që “të hapen hapën shkolla në gjuhën turke në Maqedoninë Perëndimore. Ndërsa shkolla shqipe Normale në Tetovë të mbyllet dhe pranë Shkollës Normale në Shkup (në gjuhën maqedonase), të hapen paralelet në gjuhën turke dhe atë shqipe”.<sup>1903</sup>

Po aty, thuhej “të ndërmerreshin masa për pastrimin e mësuesve jo të përshtatshëm politikisht dhe të dobët profesionalisht në mënyrë që, hap pas hapi, të shkohet edhe drejt pastrimit të mësuesve të ardhur nga Shqipëria”, edhe pse shumë prej tyre, nga mungesa e mësuesve shqiptarë në Maqedoni, ishin sjellë nga Tirana në saje të marrëveshjes jugosllave-shqiptare të vitit 1945 për t’i ndihmuar përhapjes së arsimit shqip në Maqedoni.<sup>1904</sup>

Me akuza të ngjashme u ballafaquan edhe disa intelektualë dhe politikanë shqiptarë, të cilët luftonin për shkollën shqipe dhe arsimin shqiptar, ndonëse shumë prej tyre i takonin gjeneratës së njërive partizane nga radhët e shqiptarëve në Maqedoni që i ishin bashkuar frontit të përbashkët antifashist të drejtuar nga komunistët jugosllavë dhe të Shqipërisë.<sup>1905</sup>

Janë të njohura edhe diferencimet ideore, largimet nga puna e deri te proceset gjyqësore kundër atyre që kërkonin nga organet partiake të ndërpritet politika e konvertimit të “myslimanëve” shqiptarë në “turq”, çështje kjo që, ndonëse do të anashkalohet qëllimisht, në këtë problematikë përfshiu edhe strukturat më të larta partiake republikane dhe federative si dhe ato të pushtetit ekzekutiv, që qëndrimet politike të jenë në përputhje edhe me ato administrative në mënyrë që shpërngulja të shkonte sipas parashikimeve.

---

<sup>1903</sup> Po aty.

<sup>1904</sup> Po aty.

<sup>1905</sup> Përmasat e fushatës kundër intelektualëve shqiptarë dhe arsimtarëve që nuk pranonin të punonin në dëm të shkollës shqipe si dhe kundërshtonin hapjen e shkollave të dhunshme në gjuhën turke në të cilat një pjesë e fëmijëve shqiptarë pa asnjë njohuri të gjuhës turke detyroheshin të shkonin, tregon më së miri procesi kundër intelektualit të njohur Murtena Bajraktari nga Gostivar. Në procesin gjyqësor që iu organizua në vitin 1953 deklaroi se “arsyeja kryesore që po ndiqem dhe po akuzohem si “armik i popullit” është ajo se nuk jam pajtuar të hapen shkollat turke në Tetovë dhe Gostivar, ngaqë fjala ishte për një projekt antishqiptar që kishte për qëllim , që me kovertimine tyre në tur, të shkohej kah zhdukja e shqiptarizmit. Bajraktari kishte deklaruar se nuk ishte antiturk, siç akuzohej, por patriot shqiptar që nuk pranonte turqizmin e shqiptarëve sipas programeve antishqiptare. (Shih: ДАРМ.1.427.27.58/311-340, të Lita, Qerim: “Territoret Lindore shqiptare 1912-1960”, Shkup, 2016, faqe 178.)

Ndër masat shtetërore, që duhej t'ia krijonin legjitimitetin faktorit “turk”, që shpërnguljes t'i krijohej platforma formalë, ishte edhe regjistrimi popullatës, me ç'ka do t'u jepeshin “përgjigje” politikave që ndiqeshin nga shteti, me anën e të cilave numri i shqiptarëve, i shfaqur në regjistrimin e vitit 1948, do të zbritej dukshëm, gjë kjo që mund të bëhej po qe se ngrihej numri i turqve, me ç'rast do të jepeshin edhe “arsyetimet” për këtë “ndryshim”, që tashmë, politikisht ishin tekovertuara nga qëndrimet e forumeve partiake dhe atyre shtetërore.

Kështu, në rrethanat e një represioni të shumashnshëm shtetëror kundër arsimit, kulturës dhe gjithë asaj çfarë ishte shqiptare në kuptimin klasor dhe ideologjik në Maqedoni, të vendosur sipas marrëveshjeve internacionaliste midis komunistëve jugosllavë dhe atyre shqiptarë në periudhën kohore 1944-1949, në vitin 1953, kemi regjistrimin e dytë të popullsisë.

Rezultatet e regjistrimit të vitit 1953, pasi që për dy vjet me radhë të jenë ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura në të gjitha nivelet shtetërore si dhe në të gjitha fushat: në arsim (diferencimi i arsimtarëve shqiptarë me hipotekën nacionalistë si dhe hapja e shkollave turke qoftë edhe pa nxënë ose me fare pak sosh), pastaj në kulturë (me rrudhjen e veprimtarisë kulturore si dhe vënien e saj në kornizat e vëllazërim-bashkimit, pra të zbehjes ose humbjes së identitetit kombëtar) dhe në fusha të tjera për diskriminimin e shqiptarëve dhe stimulimin e turqve, dolën në përputhje me parashikimet partiake dhe shtetërore lidhur me raportet etnike midis shqiptarëve dhe turqve, të cilat u quajtën “reale”.

U quajtën “reale”, ngaqë numri i shqiptarëve, në raport me regjistrimin vitit 1948, doli në një minus për 34.865 banorë (nga 197.389 sa ishte në 162.254), ndërsa ai i turqve u rrit mbi 100%, gjegjësisht për 107,998 banorë (nga 95.000 sa ishte në vitin 1948 në 203.000 në vitin 1953)!

Kjo statistikë e kurdisur, e ngjashme me një termet demografik, që ishte e mundshme në rrethanat e një kurdisjeje të tillë të niveleve më të larta shtetërore dhe të mekanizmave të tyre veprues, që nuk mbeti i pavërejtur edhe nga studiues objektiv maqedonas,<sup>1906</sup> po edhe nga Prishtina,<sup>1907</sup> turqit i solli në vendin e dytë (pas maqedonasve me 860.000 banorë), ndërsa shqiptarët në të tretin, që për pa-

---

<sup>1906</sup> Dr. Jovan Trifunovski në librin “*Албанско Становништво у Социјалистичкој Републици Македонији*” („Popullata shqiptare në Republikën e Maqedonisë”, Beograd 1988), kur flet për regjistrimin e vitit 1953, pos tjerash thotë se ekzistojnë dokuri që shqiptarët janë regjistruar si turq. Këso shembuj kemi në disa vendbanime të Shkupit, Kumanovës, Manastirit, Prilepit, Gostivarit dhe Resnjes si dhe në disa lagje të qyteteve.

<sup>1907</sup> Rreth metodave unitariste dhe nacionaliste për deklarimin e shqiptarëve si turq, sidomos nëpër qytetet e Maqedonisë Perëndimore dhe në Kosovë, shih Hoxha, Hajredin: “*Afirmimi i kombësisë shqiptare në Jugosllavi*”, Prishtinë, 1983, faqe 74.

sojë pat edhe ndryshimin e diskursit politik dhe atë shoqëror në përgjithësi. Sepse, radhitja pas turqve, praktikisht kërkonte “korrigjimin” në arsim, kulturë, punësim, përfaqësim, me ç’rast institucionet arsimore dhe kulturore në gjuhën turke (shkollat, bibliotekat, teatrot e të tjera) duhej t’i nënshtroheshin këtij “realiteti”, pra të rrudheshin ose të mbylleshin ato shqipe dhe të hapeshin ato në gjuhën turke. Statistika e dhunshme duhej të bënte politikën reale në Maqedoni, qëllimi kryesor i të cilës ishte që pakicës turke t’i lejohet shpërngulja për në Turqi, ndërsa shqiptarëve t’u mbyllej goja me anatemen e “dhunuesve” dhe të “zullumqarëve”, të njëjtë siç e kishte kërkuar edhe Çubrilloviqi në Elaboratin e Fundit, të tetorit të vitit 1944.

Natyrisht, që “tërmeti” statistikor në Maqedoni, duhej të përcillej edhe me arsyetimet partiake dhe ato politike dhe shtetërore, në mënyrë që çdo gjë të dukej “e natyrshme”, si “kthim në një normaliteti të mohuar”, të krijuar nga prania e Shqipërisë së Madhe gjatë viteve 1941-1944 dhe indoktrinimi “shqiptaromadh” që kishte lënë pas, indoktrinim ky që kishte vazhduar “edhe nga viti 1944-1951”, kur do t’i ndërpritet “burimi” (theksohej “propagandës së Enver Hoxhës” dhe “ndërrhyrjes e saj në punët e brendshme të Maqedonisë”), dhe në tjetrën anë të mundësisë për deklaram të lirë, i krijuar nga rrethanat e reja (raportet e mira jugosllave-turke), ku “identiteti fetar” si “fanatizmi fetar” shfaqet edhe si faktor përcaktues kundër “dhunës kombëtare” me të cilën tashmë identifikohet “nacionalizmi shqiptar”.<sup>1908</sup>

Krahas faktorit “Enver Hoxha” dhe “indoktrinimit nga ai”, që do të dalë nga analizat partiake të niveleve më të larta, faktori “deklaram i lirë”, “alibia” e faktorit fetar, me islamin, si thuhej, “lidhej me traditën shekullore të popullatës turke”, që sipas ideologëve partiakë, ishte e kuptueshme që shfaqej edhe si “e drejtë për të jetuar në përputhje me traditat fetare dhe etnike”, të rrënuara në rrethanat e reja të shoqërisë socialiste në Maqedoni, por të cilat i ofron Turqia.<sup>1909</sup>

Formula e “traditës shekullore fetare” dhe “lidhja e natyrshme me të” madje “si e drejtë elementare njerëzore” ndaj së cilës e jep provimin civilizues çdo shoqëri, gjithnjë e përcjellë me demagogji politike, shfaqet si recete për normalizimin e marrëdhënieve politike dhe diplomatike të Jugosllavisë dhe të Turqisë si dhe krijimin e rrethanave që turqit, “pasi që nuk kanë qenë të lirë të deklaroheshin turq”, por që këtë të shumtën e kishin “ngatërruar” me atë shqiptar, dhe pasi që shoqëria

---

<sup>1908</sup> По ату.

<sup>1909</sup> Shih: Ачковска, Виолета: „Колективизација на селото 1949-1953 године на македонство во Западна Македонија“, Скопје, 2000.

socialiste dhe sistemi i ri nuk përkon me mentalitetin e tyre si dhe traditat “e botës orientale”, të shpërnguleshin në përputhje “me vullnetin e tyre të lirë”.

Rreth faktorit fe (religjionit), një komision i KQ të LK të Maqedonisë, do të deklarojë se “në rastin e Maqedonisë, ishte një faktor thuajse identitar për një pjesë të madhe të popullatës së Maqedonisë Perëndimore, që nuk lejonte të ngatërruhej me atë kombëtar, siç kishte ndodhur nën trysinë e nacionalistëve shqiptarë gjatë Shqipërisë së Madhe, kur myslimanët ishin kthyer në shqiptarë, dhe siç kishte ndodhur edhe gjatë viteve të pushtetit popullor, kur një pjesë e tyre, prapë ishin trajtuar “shqiptarë”, ndonëse në familje flasin turqishten dhe i takojnë këtij mentaliteti. Hapja e shkollave në gjuhën turke, mundësia e deklarimit të lirë (jashtë trysnisë së nacionalistëve shqiptar) gjërat i ka kthyer tek normaliteti, pra te deklarimi i lirë nacional, fakt ky që edhe solli te pasqyrimi i një të vërtete “të fshehur” demografike”.<sup>1910</sup>

Është interesant të thuhet me këtë rast, se dokumentet e kohës të UDB-së jugosllave, flasin të kundërtën. Nga informatat sekrete që iu drejtuan organeve më të larta partiake del se “ndryshimi aq i lartë i strukturës nacionale midis dy regjistrimeve nuk ka ardhur nga shtimi natyror i popullatës, por nga ndryshimi i deklarimeve të shqiptarëve dhe torbeshëve”.<sup>1911</sup>

Sipas UDB-së “kjo kishte të bëjë me një ndryshim artificial të strukturave nacionale”, që nuk kishte ardhur si “një element i kristalizimit të identitetit, por shpërthim i menjëhershëm i elementit fetar dhe fanatik në dëshirën tejet të madhe për ndërprerjen e jetës në mesin e kaurëve dhe të vazhdojnë në botën dhe shtetin me fe të njëjtë si të vetën,” gjë që shpjegonte edhe atë që politika ditore tashmë e arsyetonte “si e drejtë e natyrshme e turqve që të jetojnë aty ku ndjehen të lirë”.<sup>1912</sup>

Sidoqoftë, statistikat e reja, ku numri i turqve u dyfishua dhe i shqiptarëve u pakësua për një të tretën, krijoi mundësitë reale për intensifikimin e shpërnguljes, e cila ndonëse kishte filluar në vitin 1951, nuk kishte marrë përmasat e pritura nga jugosllavët dhe Turqia. Kjo pakënaqësi vërehej, sidomos të zyrtarët dhe politikanët maqedonas, të cilët, nga viti 1951 kur i ishte dhënë “drita e gjelbër” shpërnguljes dhe kur kishte filluar konvertimi i myslimanëve në turq si parakushti kryesor për të shtruar të drejtën për shpërngulje për në Turqi, disa herë kishin shqyrtuar gjendjen, me ç’rast ishin konstatuar edhe ngecje nga ana e nacionalistëve shqiptarë, “që pengonin këtë proces” si dhe, nga ana e neglizhencës së disa organeve të pushtetit, që

---

<sup>1910</sup> Po aty.

<sup>1911</sup> ДАРМ.1.427.72.1/1-67.

<sup>1912</sup> Po aty.



deklarimi nacional të stimulohej nëpërmes masave arsimore (mendohej përfshirja sa më e madhe e nxënësve me mësim në gjuhën turke). Për t'i hequr pengesat në mënyrë që “qytetarët të deklaroheshin shpirtshëm për përkatësinë nacionale dhe identitetin fetar si pjesë e tij, Byroja Politike e KQ të LK të Maqedonisë kërkoi nga qeveria (Këshilli Ekzekutiv), që, pas regjistrimit të popullsisë si dhe “ndryshimit të gjendjes demografike” të krijojë komisione zyrtare për t'i vizituar të gjitha komunat e Maqedonisë ku do të ndihmohet popullata jo maqedonase të vendos për fatin e saj.

Krijimi i komisioneve partiake, shqyrtimet e tyre dhe konkluzionet (detyra organeve shtetërore), po ashtu ishin perfide. Sepse, fillonin me “konstatimin e gjendjes” si dhe “bregosjen” për të, duke përfunduar “me shpërndarje” të detyrave që ajo të ndryshohet, gjoja për të mirë (përmendej vazhdimisht vullneti i lirë i popullatës), por që e gjitha lidhej me programin e shpërnguljes dhe përmbushjen e tij.

Me këtë rast, Komisioni i Byrosë Politike, gjithnjë duke u mbështetur mbi të dhënat statistikore nga viti 1951-1953, ku numri i atyre që ishin shpërngulur për tri vite, mezi kalonte dy mijë veta, gjendjen e vlerësonte “të pakënaqshme”<sup>1913</sup> dhe u kërkua që të rishqyrtohet e gjithë procedura administrative (dokumentet e shumta deri te paraqitja e kërkesës zyrtare komisionit shtetëror), në mënyrë që ajo të mos kthehej në vështirësi, por të thjeshtësohet.

Përkundër pakënaqësisë me “ngecjen” në planin e përgjithshëm, Komisioni partiak, vlerësonte rritjen e kërkesave për shpërngulje në Maqedoninë Lindore si dhe atë Qendrore, (në komunat: Veles, Prilep, Manastir si dhe Qendrën e Shkupit). Thuhej se në këto pjesë, “sado që ndjenjat nacionale nuk janë të kristalizuar, vullneti për shpërngulje është i madh, deri në 90%, të atyre që janë deklaruar turq dëshirojnë të shpërngulen, ngaqë në këto pjesë myslimanët janë lënë të lirë të përcaktohen vetë, si për përkatësinë nacionale, ashtu edhe të marrin vendime për shpërnguljen”.<sup>1914</sup>

Megjithatë, nga viti 1954 deri në 1959, kur pas regjistrimit të fundit të popullatës gjendja demografike kishte ndryshuar shumë në dobi të kombësisë turke, e cila, në numrin e përgjithshëm të popullatës në Maqedoni, duke dalë në vendin e dytë, kishte tejkaluar atë të kombësisë shqiptare për një të tretën, do të fillojë fushata e intensifikuar partiake dhe shtetërore, shpërngulja do të shumëfishohet krahasuar me fillimin. Kështu, në vitin 1954 për në Turqi u shpërngulen 17,369 veta. Në vitin 1955, kjo rritje dyfishohet. Arrin në 38.045 veta. Në vitin 1956 shkon

---

<sup>1913</sup> По аты.

<sup>1914</sup> ДАРМ.1.472.60.7/116-129.

në 28.816. Në vitin 1957 shpërngulen 27.432 veta. Ndërsa në vitin 1958 shpërngulën 23.626. Deri më 15 mars 1959 do të shpërngulën 6.362 persona.<sup>1915</sup>

Pra, për tetë vite për në Turqi, sipas shifrave zyrtare jugosllave, u shpërngulën 143.800 qytetarë, ose 11% e popullatës së përgjithshme të Maqedonisë, zyrtarisht të gjithë të kombësisë turke, në të vërtetë shumica e tyre shqiptarë, që kishin ndryshuar përkatësinë kombëtare nga shkaku i shpërnguljes.

Deri te rënia drastike e numrit të kërkesave për shpërngulje dhe ngecja e saj në maj të vitit 1959, erdhi ngaqë pala turke, e cila, parashtruesve të kërkesës për shpërngulje filloi t'ua kërkonte certifikatë nga libri i amzë i lindjes, ku duheshe të figurojë përkatësia nacionale e bazuar në regjistrat e vitit 1941 e andej.

Kërkesa e palës turke që të përcaktohet kombësia në përputhje me dokumentet autentike të amzave dhe jo me ato të konvertuara mbi baza fetare (mysliman-turk), shkaktoi shqetësim te organet shtetërore maqedonase, veçmas kur, gjyqet komunale në Maqedoni dhe sekretariatet përkatëse, me direktivën federative, ndërprejnë ndërrimin e identitetit nacional në formën e një fushate, siç bëhej,<sup>1916</sup> ngaqë edhe rishqyrtimi më i përciptë ndërkombëtar, që mund t'i bëhej kësaj problematike, së cilës po i drejtoheshin kritika të shumta nga jashtë, nxirrte në pah dorën e organizuar te shtetit në të, gjë që hapte dyshimin e një etnocidi. Kjo Titos do t'i nxirrte telashe të mëdha veçmas jashtë, kur ishte në rrugë e sipër që të afronte rreth vetit vendet e “botës së tretë” në kuadër të lëvizjes së mosinkuadrimit prej nga ai do të kthehet në një lider botëror.

Historiografia maqedonase, po as ajo shqiptare, pos përshkrimit publicistik të saj, nuk i ka kushtuar vëmendje të duhur shpërnguljes së viteve të pesëdhjeta si dhe faktorëve që e nxitën dhe e përkrahën për të ardhur deri në shkallën që erdhi me rreth 150 mijë të shpërngulur, veçmas kjo e dyta, duke e paraqitur atë vetë si një “insert” të politikës antishqiptare jashtë kontekstëve gjeopolitik si dhe lëvizjeve të rëndësishme rajonale.

Megjithatë ajo u ndërpre, në një rënë anë, nga trysnia e faktorit ndërkombëtar, me ç'rast në forume të ndryshme ndërkombëtare, shoqata të ndryshme, po edhe nga shteti shqiptar, filloi të ngrihet zëri dhe të protestohet për ndodhjen e një etnocidi shtetëror ndaj shqiptarëve, gjë që e detyroi edhe Turqinë, e cila kishte parasysh raportet me shtetin shqiptar, po edhe me shqiptarët e shumtë në Turqi me origjinë nga viset shqiptare (Kosova dhe Maqedonia), të cilët gjithnjë e më

---

<sup>1915</sup> ДАРМ.1.427.128.5-23-39, te Lita, Qerim: “Territoret Lindore shqiptare 1920-1960”, Shkupt, 2016, faqe 199.

<sup>1916</sup> Po aty.

shumë protestonin te shteti turk se me këtë veprim po ndihmonte politikën anti-shqiptare serbe që atë ta ndërpresë.

Krahas, faktorëve të jashtëm, që patën ndikim në ndaljen e shpërnguljes për në Turqi, të cilët kërkojnë një thellim të veçantë dhe një analizë të gjithanshme, mund të thuhet se ajo u ndikua edhe nga vetë lëvizjet e brendshme politike në Jugosllavi, ngaqë shpërngulja e shqiptarëve për në Turqi rrëronte baraspeshën politike në federatën jugosllave në dobi të unitarizmit serb, ndërkohë që çrregullonte edhe raportet e brendshme me shqiptarët, sidomos me ata të Kosovës, që edhe ashtu ishin të pakënaqur me statusin e tyre nën Serbi, siç çrregullonte edhe raportet me Shqipërinë, ndaj të cilave Titoja kishte një vëmendje të veçantë, që të mos ashpërsoheshin, sidomos pas ardhjes së Brezhnjevrit në krye të BRSS-së, nga shkaku se kjo mund ta kthente serish Enverin kah Moska, që do të thoshte një mundësi më tepër që tendencat unitariste serbe në vend të fitonin shkas për lëvizje të brendshme kundër Titos dhe kursit të tij në planin e brendshëm (vetëqeverisja socialiste) dhe atë të jashtëm (lëvizja e mosinkuadrimit si rreshtim i ri botëror midis blloqeve antagonistë), të cilat Moska prej kohësh i kishte parasysh dhe priste çastin e duhur të viheshin në veprim.

Edhe pse kapitulli i shpërnguljes për në Turqi i viteve 1951-1959 u përmbyll pa iu dhënë epiteti i një etnocidi, megjithatë, tregoi se zhvillimet politike në Maqedoni si dhe çështja shqiptare në të, edhe më tutje mbeti një vorbull e pleksjeverajonale të faktorëve të ndryshëm gjeopolitik dhe gjeostrategjik në menaxhim të Titos.

## ASIMILIMI I SHQIPTARËVE ORTODOKSË NË MAQEDONI

Ndalja e shpërnguljes së organizuar të shqiptarëve për në Turqi nga mesi i vitit 1959 (ndonëse në forma të ndryshme ajo rrodhi edhe deri në vitin 1961), nuk e ndali veprimet zyrtare maqedonase dhe jugosllave për ndryshimin e hartës demografike të Maqedonisë me rritjen e numrit të maqedonasve me anën e dy metodave të ndryshme. Në njërën anë të sjelljes së popullatës sllavo-maqedonase të njohur si “egejca” nga Greqia. Fjala është për refugjatë politikë, të cilët, gjatë luftës qytetare në Greqi (1946-1949), kishin emigruar në shtetet e Evropë Lindore (BRSS-ja, Çekosllovakia, Polonia, Hungaria, Rumania dhe të tjera). Dhe të asimilimit të shqiptarëve të besimit ortodoks në maqedonas dhe pjesërisht serbë me anën e përkatësisë fetare ortodokse.

Veprimi i parë, pra “tërheqja” e sllavo-maqedonasve nga pjesa e Egjeut në Greqi për në Jugosllavi, kishte qenë një projekt që ishte iniciuar në vitet e pesëdhjeta, pas përfundimit të luftës qytetare në Greqinë, kur një pjesë e refugjatëve politikë ishte shkapërderdhur nëpër vendet lindore dhe atje ishte deklaruar “sllavo-maqedonase”. Vendosja e tyre për në Maqedoni kishte filluar nga fillimi i viteve të gjashtëdhjeta dhe kishte vazhduar për një deçenie të tërë.<sup>1917</sup> Shumica prej tyre, me tretmanin e “popullatës së riatdhesuar” u dërguan në viset shqiptare në Maqedoni (të shumtën në Pollog), në mënyrë që atje të balancohet struktura populatavenë dobi të asaj maqedonase, e cila ishte pakicë në këto anë. Numri më i madh i “egej-cave” u vendos në pjesët e Dibrës, të Gostivarit e deri në Tetovë. Një pjesë e mirë e tyre u vendos edhe në rrethin e Manastirit, në pronat e shqiptarëve të shpërngulur për në Turqi, të blera nga shteti.

Kjo popullatë e privilegjuar me prona, punësim, arsimim e të tjera, njëherësh u kthye në faktor të hapur diskriminues për shqiptarët, ngaqë një pjesë e mirë e tyre u rekrutuan në shërbimin policor, prej nga, në forma të ndryshme, filluan të ushtrojnë dhunë dhe presion ndaj shqiptarë, që të privohen nga edhe ato pak të drejta qytetare që u takonin, praktikë kjo që do të dalë në pah vite më vonë edhe nga disa analiza kritike të organeve më të larta partiake jugosllave nga fundi i viteve të gjashtëdhjeta në të cilat bëhet fjalë për deformimet ndaj popullatës shqiptare.<sup>1918</sup>

Ndërprerja e shpërnguljes së shqiptarëve për në Turqi si dhe sjellja e “egej-cave”, ndonëse nuk sollën frytet e pritura në përputhje me parashikimet që faktori etnik shqiptar të rrudhej sa më shumë që të ishte e mundur, Shkupin nuk do ta ndalë që të vazhdojë politikën e kahershme të shfrytëzimit të përkatësisë fetare (ortodokse), që shqiptarët e krishterë t’i asimilojë në maqedonas.

Ç’është e vërteta, përdorja e recetës së shfrytëzimit të përkatësisë fetare (ortodoksisë) për qëllime politike hegjemoniste nuk ishte as e re e as e panjohur për Shkupin. Beogradi e kishte përdorur atë nga koha e okupimeve të trojeve

---

<sup>1917</sup> Sipas një analize me titullin “Çështja aktuale në lidhje me vendosjen e bashkëkombësve nga pjesa e Maqedonisë së Egjeut”, hartuar në dhjetor 1974 nga Këshilli për Çështje të Emigracionit pranë Këshillit Ekzekutiv të RS-të Maqedonisë, thuhet se deri në vitin 1968, nga shtetet e Evropës Lindore (BRSS-ja, Çekosllovakia, Polonia, Hungaria, Rumania etj, janë sjellë dhe vendosur në Maqedoni gjithsej 10.182 familje me 34.915 anëtarë. Ndërsa nga viti 1968 e deri në 1974 edhe 932 familje me 3.224 anëtarë. Qeveria Maqedonase, kishte vendosur që ky proces të mbetet i hapur deri në vitin 1974, gjë që brenda kësaj kohe do të sillen dhe vendosen në maqedoni edhe 4.000 familje të tjera me rreth 21 anëtarë, gjë që numri i përgjithshëm shkon në 55 mijë veta të vendosur në Maqedoni. Shih: Dok. ДАРМ.1.159.к.327, Анализа на Советот за емиграционото прашања, Скопје, X. 1974 te „Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974”, Shkup, 2018, libri i parë, faqe 40.

<sup>1918</sup> Shih dokumentin nga Arkivi i Sllovenisë (Arhiv Slovenije) F. 1589 nga mbledhja e KQJ-së, Beograd, 20.01.1969 te Lita, Qerim: “Territoret lindore shqiptare 1912-1960”, Shkup, 2016, faqe 170).

shqiptare gjatë Luftërave Ballkanike (1912-1913) si dhe atyre të ripushtimit të tyre pas Luftës së Parë Botërore në vitin 1918. Duke u mbështetur në projektet hegjemoniste (“Naçertanjen” e Garashaninit të vitit 1844) dhe të tjerat më pas, Beogradi vuri në veprim gjithë infrastrukturën kishtarë (frymëzuesen shpirtërore të hegjemonizmit serb) dhe atë “shkencore” - historianët nga radhët e Akademisë Serbe të Shkencave, veçmas ata që vinin nga “shkolla sllaviste” e Vjenës (Gopçeviqi, V. Karaxhiqi, Jastrebovi e të tjerë) si dhe ata nga Parisi (J. Cvijiq, S. Novakoviç e të tjerë), që faktorin e ortodoksisë ta përdorin për qëllime politike: në njërën anë që atë ta kthejnë në vetëdije kombëtare sipas formulës së njohur të helenizmit (kush është grek është ortodoks, dhe kush është ortodoks është grek), dhe në tjetrën anë, me të të asimilojnë shqiptarët e besimit ortodoks për t’i futur në projektet e tyre të shetndërtimit, siç u veprua nga kryengritja e parë e vitit 1804 dhe te ajo e dyta e vitit 1815 e këndeje. Kjo strategji do të përdoret veçmas në Kosovë dhe Maqedoni pas pushtimeve të tyre në vitet 1912 dhe ripushtimit në vitin 1918. Fillimisht mbretëria serbe, në vitet 1912-1915 dhe, pastaj Mbretëria Serbe-Kroate-Slllovene, në vitet 1919-1926 dhe, më vonë, Mbretëria e Jugosllavisë (1926-1941), do të veprojnë që popullatën shqiptare të besimit ortodoks në të ashtuquajturën “Serbi e Vjetër” (e projektuar nga S. Gopçeviqi, J. Cvijiqi, Haxhivasileviqi dhe të tjerë, “qendër shpirtërore mesjetare serbe, e rrënuar nga islamizimi i dhunshëm i serbëve” si dhe kthimi i tyre “në arnautashë”),<sup>1919</sup> ta “riserbizojnë” me metoda shtetërore dhe madje kjo të konsiderohet edhe si “misionarizëm në dobi të qytetërimit përëndimor”.<sup>1920</sup>

Natyrisht se në këtë proces, në vitet 1912-1941, duhej të përfshiheshin në radhë të parë shqiptarët e besimit ortodoks, të lidhur me kishin ortodokse serbe, pastaj vllahet e shkëputur nga amza e tyre në vilajetet shqiptare (Maqedoni Përrëndimore dhe Traki) si dhe sllavo-maqedonasit, edhe pse etnografi i njohur Cvijiq përnga mungesa e vetëdijes kombëtare dhe mungesa e identitetit etnik i shih-te të mjegulluar, ndonëse gjuhësisht shfaqeshin bullgar.<sup>1921</sup>

Për Gopçeviqin, “misionarizmi” për përfshirjen e popullatës së gjithëmbarshme të përkatësisë ortodokse në Kosovë, Maqedoni në gjirin e popullit serb, sidomos i shqiptarëve “arnautash”<sup>1922</sup> dhe serbëve “të bullgarizuar”, shfaqej edhe koncept stra-

<sup>1919</sup> Хађивасилевил, Јован: „Стара Србија и Македонија“, Београд, 1939.

<sup>1920</sup> По ату.

<sup>1921</sup> Цвијич, Јова: „Основе за географију, геологију Македоније и Старе Србије“, Београд, 1911-

<sup>1922</sup> Sipas Gopçeviqit po edhe të tjerëve, termi “arnautash” paraqiste serbët, të cilët, gjatë Perandorisë Osmane, kishin qenë të detyruar ta pranojnë islamin dhe si të tillë ishin “shqiptarizuar”! Andaj, kjo popullatë “arnautashe” ishte sllave, dhe si e tillë, duhej të dëshmonte “praninë mesjetare serbe në Kosovë” (të quajtur

tegjik shtetëror dhe politik, meqë rikthente “qytetërimin e krishterë evropian” në një hapësirë historike ku ai ishte rrënuar dhunshëm nga pushtimet osmane.<sup>1923</sup>

Autorët e kësaj “shkolle” kryesisht nga “qarku sllavist” i Vjenës, që merrej me krijimin e platformës politike për shtete e reja të sllavëve të jugut (Serbisë, Malit të Zi, Bullgarisë) për t’i takuar “sferës perëndimore” dhe jo asaj ruse, mbështeteshin nga “platforma” e Cvijiqit se “sllavët e Maqedonisë” (si koncept gjeografik dhe assesi politik siç do të ndodhë me ngritjen e saj në fillim të shekullit XX), do të mbështesin secilën forcë ushtarake që zëvendëson atë osmane. “Nëse vijnë bullgarët, do të deklarohen – bullgarë. Nëse vijnë ushtarët serbë – do të deklarohen serbë... E rëndësishme që ata të kenë si mburojë kishën ortodokse...Deklarimi kombëtar për ta është çështje e pushtetit...”<sup>1924</sup>

Kjo platformë hegjemoniste, në vilajetin e Kosovës dhe atë Manastirit, që do të jenë në epiqendër të luftërave ballkanike 1912-1913, fitonte peshë të veçantë në raport me shqiptarët shumicë të këtyre viseve dhe vllahët pakicë, ngaqë aty, me konvertimin e përkatësisë fetare në atë kombëtare, shqiptarët dhe vllahët asimiloheshin dhe ktheheshin në serbë. Këtij procesi, për të marrë formën e prerë, duhej t’i ndihmonin programet shtetërore nëpërmes arsimit (shkollimit në gjuhën serbe) si dhe “integrimet” kulturore në shoqërinë serbe.

Natyrisht se për Beogradin metoda e konvertimit të faktorit fetar në identitet kombëtar, sprovën më të mirë e kishte dhënë te themelimi i shtetit grek, kur pjesa më e madhe e shqiptarëve ortodoks nga Epiri dhe e Arvanitëve nga Morea, ishin vu në shërbim të kësaj ideje, së cilës i kishte shërbye thirrja e Odesës për revolucionin grek për “rikthimin e Greqisë antike”, të drejtuar po ashtu nga arvanitas që drejtonin Komitetin Revolucionar.<sup>1925</sup>

Sapo të okupojë viset shqiptare, në përputhje me strategjinë antishqiptare, Beogradi, krahas metodave të gjenocidit kundër shqiptarëve të besimit myslimanë (vrasjeve, shpërnguljeve dhe rrënimit të vendbanimeve të tyre), ndërmori masa të shpejta që shqiptarët e besimit ortodoksë të “merreshin në mbrojtje”, duke u

---

Serbi e Vjetër), me çka “legjitimohet” edhe e drejta historike serbe në Kosovë, përkundër asaj se në shekullin XX serbët shfaqeshin si pakicë në këtë pjesë.

<sup>1923</sup> Гопћевич, Спиридон: „Стара Србија и Македонија“, Београд, 1890 dhe Хађивасилјевић, Јован: „Арнаути – наше крви арнаутиа“, Београд 1939.

<sup>1924</sup> Цвијич, Јован: „О етнографији македонских словена“, Београд, 1906.

<sup>1925</sup> *Ypsilanti*, emigrant politik nga Maqedonia, i vendosur në Odesë, ku do të themelojë Komitetin Revolucionar për Greqinë. Prej andej do të drejtojë thirrje për çlirim nga Turqia. Në atë thirrje ftohen të gjithë që të themelojnë shtetin e përbashkët grek. Aty përfshihet edhe thirrja shqiptarëve ortodoksë që të luftojnë për shtetin grek, që do të jetë i përbashkët.

shpallur serbë. Serbë, po ashtu u shpallën edhe të ashtuquajturit “serbë të bullgarizuar”, pra bullgarët që i takonin amallgamit sllavo-maqedonas.

Krahasuar me telashet që Beogradit i vinin me gjenocidin dhe me vonë etnocidin ndaj shqiptarëve të besimit mysliman (si shumicë) si dhe masave që duhej ndërmarre, asimilimi i shqiptarëve ortodoksë në serbë bëhej thujse i pavërejtur, ngaqë ishte kisha ortodokse serbe, e cila përkujdesej që i gjithë procesi të zhvillohej “i qetë”.

Kështu, në Kosovë dhe në Maqedoni, një e treta e popullatës shqiptare e besimit ortodoks dhe të gjithë sllavo-maqedonasit (kryesisht bullgarë dhe vllahë), nëpërmes kishës si dhe dhunës shtetërore, u kthyen në serbë.

Ky proces, në raport me sllavo-maqedonasit, u ndërpre në gusht të vitit 1944, në kuvendin e ASNOM-it kur u krijua Maqedonia e AVNOJ-it si “shteti i kombit maqedonas”. Ndërsa për shqiptarët e besimit ortodoks, ky proces vazhdoi edhe më tutje. Por, këtë herë, përkatësia “serbe” u zëvendësua me atë “maqedonase”.

Logjika e fituesit me armë, siç e thoshte J. Cvijiqi dhe gjuha e shtetit (shpallja e maqedonishtes gjuhë zyrtare e republikës) si identitet zyrtar, luajtën rol vendimtar që shqiptarët e besimit ortodoks në Maqedoni (me përjashtim të një numri të vogël), të shfrytëzojnë besimin fetar për të siguruar mbijetesë por edhe privilegje qytetare. Kështu që një pjesë e tyre u kthyen në maqedonas, ndërsa pjesa tjetër, e lidhur me federatën dhe Beogradin, ruajti përkatësinë serbe si një mundësi për përfitime të dyfishta: në raport me Serbinë dhe Maqedoninë.

Edhe përkundër këtyre realiteteve të vendosura me dhunë, megjithatë, duke e ditur se konvertimi i përkatësisë fetare në identitet kombëtar jo gjithnjë mund të jetë i suksesshëm ngaqë janë faktorët historikë (etnikë, kulturore) po edhe ata politikë që ndikojnë në lëvizjet e tyre, politika maqedonase, duke u mbështetur mbi atë hegjemoniste serbe, u përpoq që, së paku në aspektin “historiografik” të ruajë diskursin e “akademikëve” të Beogradit, që sloganin e njohur “se historikisht identiteti kombëtar serb lidhet me besimin ortodoks”, ta lokalizojë me riformulimin se “ortodoksia u takon edhe maqedonasve”, me çka ajo pranohet edhe si pjesë e identiteti kombëtar.

Por, në rrethanat e reja, për t’u mbrojtur nga përgjegjësia historike e pjesëmarrjes në një proces të dhunshëm asimilues, siç ishte ai i regjistrimit të shqiptarëve ortodoksë në maqedonas, Qeveria e Maqedonisë, në vitin 1950, pra kur do të prishen marrëdhëniet “vëllazërore me komunistët shqiptar” dhe Enver Hoxhën, hapi çështjen e “gjenocidit shqiptar mbi elementet sllave”, me ç’rast u hartuan

disa “analiza” në të cilat shqiptarët paraqiteshin “dhunues të trevave sllave”,<sup>1926</sup>të filluar në “Rekën e Epërme”,ku “elementi sllav” në rrethanat “e zullumit të madh shqiptar, ia ka dalë që duke ndërruar besimin (pranimin e islamit) të ruajë gjuhën amtare”.<sup>1927</sup>Sipas “analizës” së komunistëve maqedonas, që do të pranohet nga qeveria dhe do t’u rekomandohet grupeve arsimore për shkrimin e “historisë së re”, me të cilën binin poshtë “rekomandimet” nga viti 1945 që bazë për shpjegimin e historisë së shqiptarëve nëpër shkollat fillore në gjuhën shqipe në Maqedoni të shërbenin tekstet e Tiranës komuniste, shqiptarët, që në të gjitha marrëveshjet komuniste midis Tiranës dhe Beogradit shfaqeshin “popull”, rrudheshin në pakicë “të dhunshme”, pa histori, ku shfaqeshin “zullumqarë”.

Në kuadër të këtij koncepti, konteksti historik dhe ai etnik i shqiptarëve me rrënjë në antikitet, që jo vetëm ishte pjesë e qytetërimit perëndimor, por edhe kishte ndërtuar strukturat shoqërore dhe politike të tyre (nga perandoritë dhe mbretëritë më të rëndësishme të kohës), dhe ndër të parët kishte pranuar edhe krishterimin nëpër trungun e të cilit, gjatë Bizantit, kishin kaluar edhe ndarjet midis ritit lindor dhe atij perëndimor, duhej të privohej nga çdo lidhje me krishterimin, sidomos me krishterimin ortodoks, të cilit i kishte takuar pjesa më e madhe e tyre në mesjetë, prej nga, një pjesë kishin kaluar në islam, por një e treta edhe më tutje kishte ruajtur këtë përkatësi. Dhe, për ta treguar krishterimin ortodoks si “identitet fetar sllav”, që ishte “shqetësuar” nga “dhuna e shqiptarëve”, një pjesë e të sllavëve (maqedonas) të krishterë, kishin pranuar gjuhën shqipe! Të tillët gjendeshin në vendbanimet Beliçicë, Duf, Kiçinë, Vërban dhe Brodec te Rekës së Epërme.<sup>1928</sup>

---

<sup>1926</sup> Fjala është për Elaboratin e Qeverisë së RP të Maqedonisë nga viti 1950 në të cilin, pos tjerash thuhet se “Perandoria Turke ka qenë kryesisht pasive lidhur me depërtimin e shqiptarëve në Maqedoninë Perëndimore. Kjo është vetëm një ndër arsytet. E dyta, shqiptarët jetonin në kushte të rënda ekonomike dhe i kanë mashtruar brinjët e pasur sllavë në lagjet e pasura me kullota në Korab dhe Sharr. Depërtimi i parë kryhet kryesisht nëpër këto male: vidhet bagëtia, dhe stanet dhe kështu Korabi dhe Shari bëhen male të hajdutëve – siç jnë thë atëherë. Domethënë - ky depërtim kryhet me forcë dhe terror ndaj popullatës sllave, nëpërmjet grupeve të armatosura prej 200-300 vetë, nën udhëheqjen e ndonjë të pari të fisit”. (Shih: ДАРМ.1.427.27.268-295, *Анализа на шиптарското малцинство- работено од 17.01. до 10.02.1952 година*, te Lita, Qerim: “Territoret lindore shqiptare 1912-1960”, Shkup, 2016, faqe 166).

<sup>1927</sup> По ату.

<sup>1928</sup> Se banorët e fshatrave të përmendura të Rekës së Epërme ishin shqiptarë ortodoksë, të serbizar gjatë pushtimit serb dhe të maqedonizuar në vitin 1945, flet edhe statistika e vitit 1900, me ç’rast në katundin Okushë shfaqen 14 shtëpi shqiptarë ortodoksë dhe 100 shtëpi shqiptarë myslimanë. Në Duf të Gostivarit shfaqen 860 banorë shqiptarë ortodoksë dhe 180 shqiptarë myslimanë. Në Ribnicë (Radikë) kemi 120 shqiptarë ortodoksë dhe 200 shqiptarë myslimanë. Në Niçur (Rekë e Epërme), 250 shqiptarë ortodoksë dhe 220 shqiptarë myslimanë. Në Beliçicë (Rekë e Epërme) kemi 450 shqiptarë ortodoksë.(Shih:Тодоровски, Гкигор – Стојановски, Александар, Ивановски, Орде: „Миграционо движење на шиптарското малцинство во Македонија“, Скопје, 1965, faqe 8-46).



Me këtë mashtrim flagrant të organit më të lartë partiak të Maqedonisë dhe të Qeverisë së Shkupit, kërkohet të mjegullohet e vërteta për përkatësinë e madhe të krishterimit ortodoks në radhët e shqiptarëve të Maqedonisë Perëndimore dhe në Traki, si pjesë e identitetit të tyre shpirtëror nga shekulli IV e këndej kur në Dardani dhe Ilirik do të zyrtarizohet krishterimi, të asimiluar me rastin e pushtimeve serbe më 1912 dhe të riasimiluar në maqedonas me rastin e ripushtimit sllavo-komunist të vitit 1944.

Kjo, megjithatë, nuk mund ta fshehë faktin se krishterimi ortodoks, me kryeqendër peshkopatën e Ohrit, në këto pjesë ishte pjesë e identitetit shpirtëror të shqiptarëve, përkundër gjuhës kishtare (një përzierjeje bullgare-vllahe-sllave), gjatë gjithë mesjetës për të mbetur i tillë, te një pjesë e madhe e shqiptarëve të këtyre anëve, edhe gjatë sundimit osman. Ky fakt do të pranohet edhe në rivalitetin e kishave për qëllime hegjemoniste në shekullin XIX midis kishës serbe, asaj bullgare dhe greke për përvetësimin e kësaj popullate në përputhje me politikën grabitqare të shteteve të sapokrijuara në pjesën evropiane të Perandorisë Osmane (Malit të Zi, Serbisë, Greqisë dhe Bullgarisë) kur për t'u copëtuar tokat shqiptare do të hapet artificialisht kriza e Maqedonisë, që kishte çuar te Luftërat Ballkanike të viteve 1912-1913. Hiq udhëpërshkrimet e gjuhëtarëve dhe diplomatëve të njohur gjermanë, francezë, britanikë dhe të tjerë si J. G von Hahn, lordi Bajron, Fallenmayer, Grin, F. Lippich, mis Durham e të tjerë dhe studimet gjuhësore dhe etnografike prej shumë syresh nga fillimet e shekullit XIX, me të cilat vërtetohet prania e faktorit ortodoks të shqiptarët në Greqi, Traki, Maqedoni dhe Kosovë e deri në Serbi madje, për praninë madhe të shqiptarëve të besimit ortodoks në pjesën më të madhe të vilajetit të Manastirit, Janinës dhe të Kosovës, falsin edhe raportet ndërkombëtare që do t'i dërgohen Konferencës së Ambasadorëve nga komisionet e tyre për caktimin e kufijve të Shqipërisë londineze me Greqinë dhe Serbinë e atëhershme në periudhën 1913-1915 si dhe ato për Konferencën e Paqes në Paris 1919-1920, me ç'rast dëshmohet se një pjesë e madhe popullatës nga tokat shqiptare që do t'i jepen Serbisë dhe Greqisë janë të besimit ortodoks. Me këtë rast përmenden edhe vendbanimet si dhe numri i tyre, që më vonë, nga Beogradi dhe Athina, do të fshihen fare, ngaqë do të asimilohen në serbë, grekë ose malazias.

Mjafton këtu të jepen vetëm disa të dhëna nga konsulli dhe më vonë diplomati austro-hungarez Teodor Ipen, si këshilltar në Konferencën e Londrës nga dhjetori 1912 deri në gusht 1913. Ipen sjell të dhëna interesante nga komisionet ndërkombëtare që ishin marrë me hulumtimin e përkatësisë fetare dhe kombëtare të popullatës në Dukagjin, Kosovë dhe sidomos në pjesën e Pollogut të Maqe-

donisë, në kohën kur bisedohej që këto pjesë (Gjakova në Dukagjin dhe Dibra në Pollog) të mbeteshin brenda kufijve të shtetit shqiptar londinez, ose t'i jepeshin Serbisë që i kishte pushtuar në emër “të çlirimit” (siç do të ndodhë në të vërtetë). Gjatë polemikave me përfaqësuesin rus Petrajevin, që ishte një zëdhënës i flaktë i pushtimeve serbe ndaj tokave shqiptare dhe kërkonte që me pretekstet e përkatësisë fetare (ortodoksisë) këto pjesë t'i mbeteshin Serbisë, ngaqë “ortodoksët anejpari ishin sllavë, pra serbë nga mesjeta e këndej”, gjë që kjo sipas Petrajevit, dëshmohej edhe me manastiret ortodokse serbe: të Deçanit, Pejës, Deviçit e të tjerë, Ipen përdor argumentet se “ortodoksë ishin edhe një pjesë e mirë e popullatës shqiptare në Dukagjin dhe në Dibër bashkë me rrethinë” dhe se, “listat ruse për sllavët e atjeshëm, nuk paraqesin tjetër pos popullatën autoktone shqiptare, që fliste shqipen, çështje kjo që mund të dëshmohej, siç ishte dëshmuar edhe nga komisionet përkatëse”.<sup>1929</sup>

Me këtë insinuatë hapet edhe çështja e “islamizimit” të dhunshëm si dhe “ruajtja e identitetit sllav” në kuadër të “rigrupimeve” te Goranët, Torbeshët dhe të tjerët, që në të kaluarën (mendohet gjatës kohës së bashkimit të trojeve shqiptare 1941-1944), janë deklaruar “shqiptarë” gjoja nën trysninë e nacionalistëve shqiptarë gjatë kohës së “Shqipërisë fashiste”.<sup>1930</sup>

Natyrisht se hapja e çështjes së “deklarimit të dhunshëm” të grupeve etnike të goranëve dhe torbeshëve shqiptarë, në rrethanat e reja, nuk bëhej për t'u mbrojtur grupet e tilla etnike nga trysnia (shqiptare), por përkundrazi për t'u mbajtur e mbyllur çështja e asimilimit të shqiptarëve të besimit ortodoksë në maqedonas, po edhe serb, ngaqë nëpërmes hapjes së saj dekompozohet çështja maqedonase, si “një konstrukt politik” me të cilin ajo lidhet,<sup>1931</sup> ndërkohë që nëpërmes deklarimit “të lirë” të goranëve dhe të torbeshëve shqiptarëve t'u shkëputeshin edhe më tutje pjesë të rëndësishme.

<sup>1929</sup>Shih Wernicke, Annelise: “Teodor Ipen dhe Shqipëria në fokusin e Perandorisë Austrohungareze”, Tiranë, 2012, faqe 109-122. Në këtë libër, pos tjerash autorja Wernicke sjell bisedat e Ipenit me diplomatit rus Petrajev rreth manastirit Shën Ivani të Bigurit afër Dibrës, me ç'rast Ipen e kundërshton qëndrimin e diplomatit rus kur thotë se ai ishte sllav. Ipen ia bën me dije se manastiri ishte bizantin dhe se ortodoksët e Rekës nuk qenë sllavë, por shqiptar. Me këtë rast Ipen sollti edhe dëshminë e nxjerrë nga prifti dhe mësuesi i shkollës Galiçik flisnin plotësisht shqip dhe se kjo ishte e vërtetë për të gjithë banorët e atjeshëm.

<sup>1930</sup> Lita, Qerim: “Territoret lindore shqiptare 1912-1960”, Shkup, 2016, faqe 163-187.

<sup>1931</sup> Kontekstin politik të ngritjes së çështjes maqedonase gjatë Krizës Lindore por edhe mbajtjen e saj në lojë për qëllime politike kryesisht të lidhur me fatin e popullësisë shqiptare në këtë pjesë, si shumicë, e shpejton fare mirë A. Balducci në librin “La questione Macedone in rinvardo all Albania e la riforme nella diplomacia Europea”, 1903 (faqe 159-157) kur thotë se “përderi sa shqiptarët të jenë shumicë në këtë trevë, siç janë të vërtetë, nuk mund të ketë as projekt të qendrueshëm për Maqedoninë si shtet të maqedonasve, pos nëse ai shpallet mbi bazat e përkatësisë fetare (krishterimit ortodoks), paçka se edhe aty shqiptarët shfaqen si shumicë.”

Ky diskurs, pak a shumë do të vazhdojë, deri nga mesi i viteve të shtatëdhjeta të shekullit të kaluar, për t'u rikthyer së voni (pas shpalljes së Maqedonisë shtet i pavarur në vitin 1991), kur një pjesë e shqiptarëve të asimiluar dhunshëm pas pushtimeve serbe të viteve 1913 dhe atyre 1918 dhe 1944, do të shtrojnë çështjen e identitetit të tyre, duke u deklaruar shqiptarë. Disa prej tyre, duke botuar edhe libra, sjellin dëshmi të shumta rreth dhunës shtetërore të përdorur ndaj tyre për t'u deklaruar maqedonas, sidomos ndaj shtresës intelektuale,<sup>1932</sup> gjë që e gjitha nxori në pah dimensionin e politikës antishqiptare, që përkatësia e tyre fetare (ortodoksia) të shfrytëzohet për t'i kthyer në maqedonas ose serbë, politikë kjo që në shekullin XIX dhe të XX kishte ndikuar edhe formimin e shtetit serb dhe atij maqedonas.

Edhe pse deklaratimet dhe vetëdeklarimet e personave të caktuar rreth asimilimit të dhunshëm të shqiptarëve, fillimisht në serbë dhe më vonë (nga vitet 1944 e këndej) kryesisht në maqedonas, nuk mund të ndryshojë shumë nga faktet e kryera me dhunë, ngaqë një pjesë e të asimiluarve, prej kohësh, kulturalisht dhe me metoda të tjera shtetërore janë integruar në shoqërinë maqedonase ose serbe, megjithatë kjo nxjerr në pah politikën antishqiptare të Beogradit dhe më vonë edhe të Shkupit me programe shtetërore të asimilimeve me anën e shfrytëzimit të përkatësisë fetare, gjë që konfirmon faktin se në shtet e reja (Serbia, Greqia e Mali i Zi), që u shfaqën në pjesën evropiane të Perandorisë Osmane, të pranuar me vendimet e Kongresit të Berlinit 1878, shqiptarët e besimit ortodoks, ishin faktorë vendimtar etnik, por edhe politik, që luajtën një rol të rëndësishëm në lindjen e këtyre shteteve, me ç'rast përkatësia e tyre fetare, u shfrytëzua për t'u konvertua në serbë, grekë ose malazias.

## NGA “POPULLI PUNONJËS” NË KOMB SHTETFORMUES

Me ndërprerjen e shpërnguljes për në Turqi, që ndonëse zyrtarisht kishte të bënte me “vullnetin e qytetarëve të kombësisë turke për t'iu bashkuar amëzës së tyre në përputhje me traditën dhe identitetin fetar shekullor”, formalisht u përmbyll kapitulli i etnocidit shtetëror kundër shqiptarëve, i filluar në vitet e tridhjeta të

---

<sup>1932</sup> Më gjerësisht rreth çështje së dhunës shtetërore të Beogradit dhe të Shkupit si dhe trysnisë ndaj shqiptarëve të besimit ortodoksë për t'u deklaruar maqedonas si dhe përmasave të asimilimit gjatë viteve 1944-1960, shih prof.dr. Branislav Sinadovski: “*Shqiptarët ortodoks në Republikën e Maqedonisë*”, Shkup, 2015 si dhe nga i njëjti autor: “*Josif Basgeri – rilindasi, politikani dhe publicisti i madh shqiptar*”.

shekullit XX gjatë Jugosllavisë së Versajës, për të vazhduar edhe në Jugosllavinë Titos me marrëveshjen gjentelmene në vitet e pesëdhjeta me shtetin turk.

Krahas shumë faktorëve, ndër të cilët gjithsesi të rëndësishëm ishin ata që lidheshin me projektet antishqiptare të hegjemonizmit serb të ringjallura edhe në rrethanat e shtetit komunist, megjithatë, ndërprerja e shpërnguljes për në Turqi në formën si u përmbyll, nuk mund të shihet e shkëputur edhe nga qëllime strategjike, që u përmendën kalimthi (modeli i vetëqeverisjes socialiste dhe lëvizja e mosin-kuadrimit), për të cilët Tito ishte përcaktuar dhe vepronte në përputhje me to.

Në të dy këto plane, Titoja shfaqet pionier dhe strateg i suksesshëm, paçka se ato fillimisht dukeshin iluzore. Me shkëputjen me Stalinin në vitin 1949 – Titojaia krijoi bazat reale modelit të socializmit vetëqeverisës në Jugosllavi, ku punonjësi filloi të kthehet në bashkëpronar të pronës shoqërore (në formën e një aksionari në ndërmarrje), duke e kthyer atë kah një shoqëri liberale. Ndërsa mebartjen e lëvizjes antikoloniale në anën e të painkuadruarve, për ç’gjë ai kishte merita të mëdha, praktikisht parandaloi që shtetet afrikane, aziatike dhe latinoamerikane, që shkëputeshin nga zgjedha koloniale (me luftëra ose revolucione) t’i bashkoeshin bllokut komunist, pra Bashkimit Sovjetik, investitorit kryesor në lëvizjet antikoloniale (kryesisht me ideologji komuniste dhe liderë revolucionarë: Çe Gevara, Sabato e të tjerë), që sipas doktrinës së Brezhjevit, “bota antikoloniale ishte aleate e natyrshme e komunizmit.

Këtyre qëllimeve gjithsesi u duhej klima e përshtatshme nga brenda, e përcjellë me lëvizje të mëdha dhe veprime të vendosura, me të cilat fitohej besimi, si dhe hapësira për veprim jashtë - marrëdhëniet sa më të mira politike dhe diplomatike me vendet kyçe në rajon dhe gjithandej “botës së tretë”, për të cilat vetëqeverisja shfaqej një alternativë ndaj modelit shoqëror ideologjik dhe atij kapitalist.

Pa nënçmuar rolin e faktorëve të tjerë, që pa mëdyshje shfaqen të shumtë, ndalja e shpërnguljes për në Turqi, Titos i krijoi rrethana të favorshme, që duke eliminuar shkaktarët e krizës që ngërthente dhe ushqente shpërngulja, (qërimi i hesapeve në plenumin e Brioneve në qershor 1966 me ministrin e brendshëm, Rankoviçin dhe rrymën etatiste-burokratike prosovjetike nga radhët e komunistëve serbë), t’ua hapë rrugën ndryshimeve shoqërore dhe politike në vend - atyre që lidheshin me aplikimin e vetëqeverisjes socialiste si një model liberal shoqëror si dhe reformave të thella në federatën jugosllave, të cilat do të pasojnë në fillimin e viteve të gjashtëdhjeta dhe do të vazhdojnë në ato të shtatëdhjetat me ndryshimet kushtetuese, me ç’rast federata do të mbështetet mbi konsensusin e ri të tetë njësive të barabarta, ku edhe Kosova si krahinë me status dual (njësisfede-

orative por edhe në përbërje të Serbisë), fitonte statusin e subjektit të barabartë federative ndër tetë sosh.

Përgatitja e terrenit për ndryshime të mëdha, që mundësonte ndryshimet shoqërore, po ashtu kërkonin bazë juridike-kushtetuese, të cilat lidheshin me nevojën e reformave kushtetuese, nga ato të republikave e deri te kushtetua federative. Titos ato i duheshin për ta legjitimuar modelin e vetëqeverisjes socialiste si dhe politikën e mosinkuadrimit, por që e gjitha të kalonte nëpërmes një “kozmetike” për nevojat e brendshme, me ç’rast shfaqej atributi “socialist” në vend të atij “popullor”. Kështu, “republikat popullore” definoheshin “republika socialiste”, siç do të definohet edhe federata nga ajo “popullore” në “socialiste”.

Bashkësia shtetërore socialiste u përcoll edhe me redefinimin e sovranitetit nga “popullit” te “kombet dhe kombësitë”.

Këto ndryshime ishin domethënëse, që ndonëse formalisht dukeshin se koncepti klasor “i popullit” shënonte kapërcimin nga ai klasor te ai ideologjik (socialist), gjë që lente përshtypjen se po shkohej kah përvoja sovjetike, në të vërtetë, ndodhte e kundërta, ngaqë “popullin” e zëvendësonte “kombi”, ndërsa “kombësia” “pakicat kombëtare”.

Mbi këto parime filluan edhe ndryshimet në kushtetutat e njëjësive federative, ku atributi “popullor” u zëvendësuar me atë “socialist”, ndërsa republikat u rridhuan “bashkësi socialiste demokratike të kombeve dhe të kombësive të barabarta”. Me ndryshimet e amendamenteve kushtetuese “kombet dhe kombësitë” shfaqeshin si bartës të sovranitetit, dukuri kjo e paparë deri më atëherë në praktikën ndërkombëtare.

Ky ndryshim i rëndësishëm, që nënkuptonte edhe avancimin e pozitës kushtetuese të krahinave në Serbi, për ç’gjë Tito tashmë ishte i interesuar, meqë ashtu mundësonte edhe reformimin e federatës jugosllave, megjithatë, në kushtetutën e Serbisë u amortizua me futjen e amendamentit me të cilin Serbia shfaqej si “autore” e autonomive, që mund të krijoheshin, sipas nevojave politike. Me këtë ndryshim, edhe autonomia e Vojvodinës dhe Kosovës në Serbi, e cila kishte kaluar nëpërmes federatës madje edhe pa u konstituuar “Serbia federale” në përbërje të federatës jugosllave me çka ajo kishte edhe aspektin federativ, mohohej, për faktin se autorësia e saj i bartej Serbisë, e cila, siç mund t’i krijonte ato, njëherësh, mund edhe t’i anulonte.<sup>1933</sup>

---

<sup>1933</sup> Më gjerësisht shih: Kurteshi, Salih: “Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e autonomitetit të Krahnës Socialiste Autonome të Kosovës në Jugosllavinë Socialiste”, Prishtinë, 1984.

Futja e mundësisë së anulimit të autonomisë në kushtetutën e Serbisë, ishte komploti i parë kundër kushtetutës së Jugosllavisë së vitit 1946 dhe njëherësh edhe asaj që po paralajmërohej, me ç'rast federata jugosllave duhej të demokratizohej ndërsa statusi i pakicave kombëtare, me atë të ngritjes në “kombësi”, ndonëse *nonsens*, barazohej deri të e drejta e participimit në sovranitet shtetëror. Ndaj këtyre kompleteve serbe, si do të shihet, Titoja dinak, por shumë i vendo-sur në çastet vendimtare, reagoi në Plenumin e Brionëve, në qershor 1996, me rrënimin e Rankoviçit si dhe gjithë infrastrukturës partiake të logjikës etatiste, me “dyshimin” se po përgatitej të merrte pushtetin nga brenda, synim i së cilës ishte rrënimi i kursit të vetëqeverisjes socialiste dhe kthimi i etatizmit. Me qërimin e hesapeve me kundërshtarët politik, kryesisht serbë, me ndryshimet në amendamentet kushtetuese nga viti 1968 në kushtetutën federative, Titoja ua krijoi platformën politike ndryshimeve në kushtetutën e Serbisë dhe atyre në atë federative të vitit 1974.<sup>1934</sup>

Krahasuar me Serbinë dhe përpjekjet e saj që ndryshimet kushtetuese të mos ndjekin frymën e reformave, që në raport me njësitë autonome, të shfrytëzohen për unitarizmin republikan, si një model, që do t'i imponohej edhe federatës, Maqedonia iu nënshtrua në tërësi kursit të Titos për ndryshime në kushtetutën e republikës, me të cilat ndryshohej pozita kushtetuese e maqedonasve, por edhe të shqiptarëve dhe të tjerëve në të. Kjo ishte edhe e pritshme, ngaqë, Maqedonia, e cila kishte përfiturar më së shumti në federatën jugosllave, e dinte fare mirë, se forcimi eventual i kursit etatist, siç kërkonte Serbia, në një të ardhme, edhe Maqedoninë mund ta kthente nën tutelën e Beogradit.

Kështu, në kushtetutën e vitit 1963, Maqedonia definohej “Republikë Socialiste” dhe “bashkësi shtetërore socialiste demokratike e popullit në Maqedoni, e themeluar në bazë të pushtetit të popullit punonjës dhe vetëqeverisjes”.<sup>1935</sup>

Me ndryshimet që iu bënë dispozitave kushtetuese (me amendamentet XVI dhe XVII), sovraniteti u kthehet edhe nacionaliteteve, pra kombësive.<sup>1936</sup>

---

<sup>1934</sup> По ату дхе те Рајовиќ, Радошин: “*Аутономиа е Косовџс*”, Приштинџ, 1987

<sup>1935</sup> Цаца, Горѓи: „*Уставниот развитаќ на СРМ*“, Скопје, 1983, стр. 58.

<sup>1936</sup> *Shih*: “*Kushtetua e Republikџs Socialiste тџ Маќедонисџ*” e vitit 1963, amendamenti XVI:

“Njerџzit punonjџs, populli маќедонас, kombџsitџ дхе групет етнике i realizojnџ тџ drejtat e tyre sovrane нџ Republikџn Socialiste тџ Маќедонисџ, ndџrsa нџ Republikџn Federative тџ Jugosllavisџ, кур кјо џштџ нџ интересин е пџrbashkџt тџ njerџzve punonjџs, комбеve дхе kombџsive ме marrџveshje тџ republikave дхе тџ krahinave, тџ miratuara нџ Kushtetutџn е RSFJ-sџ.

Нџ Republikџn Socialiste тџ Маќедонисџ populli маќедонас, kombџsitџ дхе групет етнике, njerџzit punonjџs дхе qytetarџt бџjnџ rregullimin е пџrgjithshџm економик-шоќџror дхе системин е пџrgjithshџm политик тџ Republikџs дхе sigurojnџ дхе realizojnџ: sovranitetin, lirinџ nazionale, pavarџsinџ, integritetin nacional тџ Republikџs.”

Këtë komponentë e pasqyron më së miri amendamenti XVII i kushtetutës së vitit 1963, në të cilin thuhet:

*“Populli maqedonas, kombësitë dhe grupet etnike në Republikën Socialiste të Maqedonisë janë të barabartë dhe kanë të drejta dhe detyrime të njëjta. Komunat dhe Republika u sigurojnë kombësive dhe grupeve etnike që të përfaqësohen përpjesëtimisht në kuvendet komunale dhe në Kuvendin e Republikës Socialiste të Maqedonisë dhe të përfaqësohen në mënyrë adekuate në organet e tyre.”*<sup>1937</sup>

Më tutje, thuhet se “çdo kombësie dhe grupi etnik i garantohet e drejta ta përdorë lirisht gjuhën e vet, ta shpreh dhe ta zhvillojë kulturën e vet dhe të themelohen institucionet dhe organizatat që do t’i sigurojnë këto të drejta”.<sup>1938</sup>

Edhe arsimit dhe kultura në gjuhët e kombësive fiton mbështetje ligjore-institucionale.

”Komunat dhe Republika kujdesen për zhvillimin e edukatës dhe arsimit në gjuhën e kombësive si dhe për zhvillimin e shtypit, radios, televizionit dhe vepërimtarive kulturore të kombësive dhe grupeve etnike.”<sup>1939</sup>

Në përputhje me këtë amendament përcaktohen edhe bartësit e përgjegjësive dhe detyrave për krijimin e kushteve për edukim dhe arsimim të pjesëtarëve të kombësive në institucionet edukative-arsimore, gjegjësisht në paralelet në të cilat edukata dhe mësimi zhvillohet në gjuhën e kombësive përkatëse.<sup>1940</sup>

Në këtë amendament përcaktohet edhe përdorimi i lirë i flamurit të kombësive dhe të grupeve etnike.

Po ashtu, me këto ndryshime, në vendet ku jetojnë pjesëtarët e kombësive, në jetën publike dhe shoqërore, gjuha dhe shkrimi i kombësive shfaqej i barabartë me gjuhën maqedonase.<sup>1941</sup>

“Në komunat ku jetojnë pjesëtarët e kombësive, vendimet dhe aktet e tjera më të rëndësishme të kuvendeve komunale dhe të organizatave punuese shpallen edhe në gjuhën e kombësive. Mbishkrimet publike nëpër këto vende janë edhe në gjuhën e kombësive.”<sup>1942</sup>

Një faktor tjetër i rëndësishëm me ndryshimet kushtetuese të vitit 1963, ishte edhe “vetëqeverisja” si kategori kushtetuese, me të cilën u hapet rruga ndryshi-

---

<sup>1937</sup> Po aty.

<sup>1938</sup> Po aty.

<sup>1939</sup> Po aty.

<sup>1940</sup> Po aty.

<sup>1941</sup> Po aty.

<sup>1942</sup> Po aty.

meve të ardhshme pozitive në jetën shoqërore dhe politike të vendit, siç janë ato të kapërcimit nga etatizmi burokratik kah liberalizimi shoqëror dhe liberalizimi i ekonomisë dhe të raporteve midis “kombeve” dhe “kombësive” si bartëse të sovranitetit shtetëror, të cilat zëvendësojnë kategoritë “shumicë” dhe “pakicë” si aspektet klasore të barazisë.

## RËNIA E RAKOVIQIT NË VITIN 1966 DHE DEMONSTRATAT E SHQIPTARËVE NË VITIN 1968

Kushtetuta e Maqedonisë e vitit 1963, e iniciuar nga Titoja dhe kursi i reformave antiburokratike në shoqëri, hapi gamën e shumë ndryshimeve të rëndësishme në jetën shoqërore dhe politike, veçmas të atyre që çonin drejt afirmimit dhe arritjes së barazisë së pakicave kombëtare, të avancuar a në “kombësi” të barabarta me “kombin maqedonas”. Këtyre ndryshimeve ua krijoi platformën partiake Kongresi IV i LK të Maqedonisë, i mbajtur më 29-31 mars 1965. Në konkluzionet që u miratuan në këtë kongres, ndër të tjera u theksua edhe “realizimi i barazisë së kombësisë shqiptare dhe turke në fushën e arsimit dhe të kulturës” si e drejtë e emancipimit kombëtar, që ofron shoqëria vetëqeverisëse, me ç’rast u kërkuar themelimi i shkollave të caktuara të shkallës së dytë në gjuhën amtare.

Në përputhje me këto qëndrime, Kuvendi i RS të Maqedonisë solli Ligjin për gjimnazet, ku për herë të parë parashihej hapja e gjimnazeve, përkatësisht të paraleleve me mësim në gjuhën shqipe. Këtë e garantonte neni 15, paragrafi 1 e 2 i këtij ligji. Gjatë vitit shkollor 1965/66 në RS të Maqedonisë, krahas gjimnazit “Kiril Pejçinovski” në Tetovë, u hapen edhe gjimnazet në Kumanovë, Gostivar, Dibër, Kërçovë dhe Strugë.<sup>1943</sup>

Një kthesë pozitive në këtë drejtim u shënua edhe në praktikën e bashkëpunimit arsimor dhe kulturor të Maqedonisë me Kosovën në përputhje me qëndrimet partiake të niveleve më të larta jugosllave rreth kësaj çështje, në mënyrë që kultura e popullsisë shqiptare të ecte rrjedhave të përbashkëta, prej nga do të fillojë ajo, në vitet në vijim, Kosovën do ta kthejë në amëz të kulturës dhe arsimit shqiptar në Jugosllavi. Në kuadër të kësaj klime, autoritetet politike të Maqedonisë dhe ato të Kosovës nënshkruan Marrëveshjen për bashkëpunimin në lëmin e arsimit e të kulturës. Marrëveshja përfshinte 6 pika, në të cilat, pos tjerash, para-

---

<sup>1943</sup> Lita, Qerim: “Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974”, libri i parë, Shkup, 2018, faqe 51.



shihej që Prishtina të marrë përsipër botimin e librave në gjuhën shqipe për shkollat në Maqedoni, ndërsa Shkupi botonte librat në gjuhën turke për shkollat në Kosovë. Me këtë marrëveshje u përfshi edhe botimi i reciprok i autorëve maqedonas në gjuhën shqipe dhe anasjelltas si dhe shkëmbimi reciprok i ansambleve dhe i shoqërive kulturore si dhe shfaqjeve teatrore.<sup>1944</sup>

Thellimit të këtij bashkëpunim i ndihmuan edhe takimet e delegacioneve të Lidhjes Socialiste të Popullit Punonjës nga Maqedonia dhe Kosova, të cilat u pajtuan për format institucionale të bashkëpunimit arsimor dhe kulturor midis Shkupit dhe Prishtinës, ku rëndësi të madhe kishte marrëveshja rreth plan-programeve mësimore rreth bërthamave të përbashkëta të gjuhës dhe letërsisë në shkollat dhe fakultete. Grupet e përbashkëta për gjuhë dhe letërsinë shqipe pranë fakultetit në Prishtinë dhe në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Shkup, duhej të përcaktonin kornizat e tyre.

Përmasat e këtij bashkëpunimi të ndërsjellë, stimuluan dukshëm veprimtarinë arsimore dhe kulturore të shqiptarëve në Maqedoni, e cila, gjithnjë në përputhje me konkluzionet partiake nga Kongresi IV të LK të Maqedonisë, po kërkonte që ta zgjeronte hapësirën, po edhe kreativitetin mbi bazat institucionale. Kështu, veprimtaria botuese në gjuhën shqipe, krahasuar me dy deceniet e kaluara kur veprat e autorëve shqiptarë numëroheshin në gishta,<sup>1945</sup>nga vitit 1964, pati një zhvillim të theksuar. Kësaj i dha shtysë Fondi Republikan për Përparimin e Veprimtarisë Botuese me lejin e botimit të revistës për kulturë art dhe shkencë “Jehona”, pastaj botimit të “*Flakës së Vëllazërimit*” nga e përmuajshme në të përjavshme dhe të disa revistave për fëmijë. Për herë të parë u botuan përmbledhje poezish të autorëve shqiptarë A. Islamit, M. Shehut, S. Selimit e të tjerëve.

---

<sup>1944</sup> Po aty, faqe 52.

<sup>1945</sup> Nga një informatë e Komisionit për pakica nacionale në maj të vitit 1959, bëhej e ditur se brenda 13 vjetëve ishin botuar vetëm 20 vepra në gjuhën shqipe, prej tyre: dy origjinale, 18 përkthime (10 nga autorë jugosllavë, 5 nga autorë të huaj dhe tri publikime me përmbajtje politike). Shih: ДАРМ.1.427.66.83-821-850, ПРЕГЛЕД на положбата на националните малцинство во Македонија, Скопје, 24.01.1959.g. Në përputhje me këtë informatë, Komiteti Ekzekutiv i KQ të LKM-së, në mbledhjen e mbajtur më 10-19 shkurt 1959 konstatoi „...veprimtaria botuese për pakicat nacionale është shumë e dobët; se nuk u është botuar as edhe literatura më e rëndomtë politike”. Nisur nga kjo, u mor qëndrimi që “Bashkarish me Kosovën të rregullohet botimi për librat dhe beletristikën tjetër; t’u ndihmohet *Flakës së Vëllazërimit* dhe *Birlikut* të përforcohen me kuadër dhe të dalin me më shumë faqe”. Në këtë mbledhje u bë fjalë edhe rreth gjuhës shqipe, ku u mor qëndrimi se “çështja e gjuhës shqipe të zgjidhet në mënyrë parimore. Këtu dilema qendron midis gjuhës letrare shqipe dhe gjuhës që përdoret në Kosovë. Kjo çështje do të duhej të parashtrohet edhe para KQ të LK të Jugosllavisë dhe së bashku me shokët nga Kosova të zgjidhet. U shpreh mendimi se nuk mund të shkohet në gjuhë gjetër, përveç gjuhës së shtetit amë”. (Dok.ДАРМ.1.159, te Lita, Qerim: “*Problemi shqiptar në RR(S) të Maqedonisë 1944-1974*”, Shkup, 2018, libri i parë, faqe 44).

Por, kthesa më e rëndësishme, drejt emancipimit të mëtutjeshëm arsimor dhe kulturor të Shqiptarëve në Maqedoni, u shfaq në verën e vitit 1966, pas mbledhjes IV të KQ të LK të Jugosllavisë e zhvilluar nga 1-6 korrik në Brione. Siç dihet, në Brione, Tito qëroi hesapet me krahun e ashtuquajtur “centralist-unitarist” të lidhur me Aleksandër Rankoviqin, bashkëpunëtor i ngushtë i Titos nga koha e luftës e këndej, njëherësh ministër i brendshëm.

Shkarkimi i Rankoviqit nga pozicionet shtetërore dhe partiake, njëherësh ua hapi rrugën reformave shoqërore dhe politike me të cilat forcohej kursi i vetëqeverisjes socialiste si dhe përmirësimi i menjëhershëm i pozitës së kombësive, veçmas të shqiptarëve në Kosovë, në Maqedoni dhe Mal të Zi. Me këtë rast, forumi më i lartë partiak kërkoi edhe përgjegjësi për gjendjen e krijuar, me çka filloi edhe i ashtuquajtur proces i diferencimit të strukturave të caktuara në radhët e shërbimit të sigurimit shtetëror dhe gjyqësor rreth keqpërdorimeve të ndryshme nga ky shërbim, për ç’gjë, forumet më të larta partiake të Maqedonisë u deklaruan me shpejtësi,<sup>1946</sup> paçka se mungoi një qasje që ato të hapen në përputhje me përmasat që kishin në të vërtetë.

Por, si do të shihet, do të jetë Kosova si dhe klima shoqërore-politike që u krijua atje që keqpërdorimet të nxirren në pa në përputhje me shkaktaret e njëmendtë (reinkarnimit i politikës antishqiptare në rrethanat e reja), të cilat ndikuan që edhe në Maqedoni të hapeshin çështjet bashkë me pasojat e tyre, ngaqë ato në sferën e kulturës dhe të arsimit ishin të ndërlidhura me identitetin kulturor dhe emancipues të shqiptarëve në Jugosllavi, i cili duhej të ishte i përbashkët dhe në përputhje me kriteret e barazisë për të cilat deklarativisht Jugosllavia angazhohej. Qasja e Kosovës që keqpërdorimeve t’u hyhet nga gjeneza, pavarësisht vendndodhjes, ktheu fokusin edhe nga Maqedonia, prej nga reflektonin shumë nga problemet në fushën e kulturës dhe të arsimit, që ndërlidheshin edhe me Kosovën, ngaqë krijonin një asimetri kriteresh si dhe realitetesh, gjë që ngjallte edhe reagimet e inteligjencies shqiptare, e cila kërkonte që barazia kombëtare të mos trajtohej me kute të ndryshme në Shkup dhe Prishtinë. Kjo do të theksohet në një takim të delegacionit të Kosovës në Beograd, në mars të vitit 1967, me Eduard Kardelin, Kryetar i Kuvendit të Jugosllavisë dhe bashkëpunëtorin e ngushtë të Titos – përgjegjës për re-

---

<sup>1946</sup> Në Mbledhjen e KQ të LK të Maqedonisë, që u mbajt menjëherë pas plenumit IV të KQ të LKJ-së, iu dha mbështetje e plotë që dolën në Brione rreth hapjes së procesit të diferencimit. “Komiteti Ekzekutiv u jep mbështetje të plotë qëndrimeve dhe konkluzionve të KE KQ LKJ-së për pastrimin urgjent të gjendes së krijuar dhe nxjerrjen para përgjegjesisë partiake të fajtorëve dhe udhëheqësve kryesorë të dukurive antisocialiste dhe antipartiake – Rankoviq dhe Stevanoviq” (Dok.ДАРМ.1.427.150.7/177-181), nga Lita, Qerim: “*Problemi shqiptar në RR(S) të Maqedonisë 1944-1974*”, Shkup, 2018, libri i parë, faqe 44).

format shoqërore, politike dhe ato kushtetuese, që do të sanksionohen në kushtetutën e vitit 1974. Në këtë takim u theksua nevoja për harmonizimin e kriterëve të përbashkëta të barazisë kulturore dhe arsimore, që do të vlenin në gjithë vendin, të ndërtuara mbi standardet e platformës partiake në nivel të shtetit.<sup>1947</sup>

Fokusimi i kreut politik të Kosovës të “kriteret e përbashkëta të barazisë kulturore dhe arsimore”, që do të vlenin për gjithë vendin, në Maqedoni do të interpretohen “si përpjekje për krijimin e një qendre të vetme për të gjithë shqiptarët e Jugosllavisë”, që nënkuptonte Prishtinën, gjë që, me direktivat e kreut më të lartë partiak jugosllav, shtroi nevojën e një takim të nivelit më të lartë partiak midis Maqedonisë dhe Kosovës, në mënyrë që “të harmonizohen qëndrimet” me të cilat “si thuhej”, “t’u mbylleshin dyert përpjekjeve të reja, që barazia të shfrytëzohet për qëllime nacionaliste”.

Takimi i tillë u mbajt në Ohër, më 7 shtator 1967. Liderët maqedonas jo rastësisht u përqendruan te “tendencat për krijimin e një qendre të vetme për të gjithë shqiptarët e Jugosllavisë”,<sup>1948</sup> ngaqë kështu dhe në këtë mënyrë, duke u hedhur topi te një çështje që shfaqej “e anatemuar” me hipotekën se kjo “sillte te krijimi i Republikës shqiptare në Jugosllavi, qendra e së cilës do të ishte Prishtina” e të ngjashme për ç’gjë në Maqedoni, brenda një kohe të shkurtër ishin dënuar mbi 170 arsimtarë dhe intelektualë shqiptarë dhe shumë e shumë të tjerë ishin përjashtuar prej procesit arsimor dhe përjashtuar nga puna,<sup>1949</sup> delegacionit të Kosovës i merrej mundësi që të shtronte problemet në përputhje me shkaktarët kryesor – diskriminimin nacional dhe keqpërdorimet nga organet e shtetit, që ishin të shumta në Maqedoni dhe lidheshin edhe me Kosovën. Natyrisht se delegacioni i Kosovës, nuk do ta hajë karremin. Bëhet e ditur se Veli Deva, kishte kërkuar që shqiptarët në Maqedoni të gëzojnë të gjitha të drejtat kombëtare që ua garantonte kushtetua, por assesi që barazia të prodhonte “një qendër prej nga ajo do të drejtohej”. Deva kishte deklaruar se “qendra jonë e vetme rreth barazisë -

---

<sup>1947</sup> Arhiv Slovenije, dok.1521, pov.br.02.212/1, Beograd, 7.VI.1967 Razgovor Predsednika Savezne Skupstine E. Kardela sa delegacijom Autonomne Pokrajine Kosova i Metohije, održan 21 marta 1967 godine (zabeleške), nga Lita, Qerim: “*Problemi shqiptar në RR(S) të Maqedonisë 1944-1974*”, Shkup, 2018, libri i parë, faqe 44).

<sup>1948</sup> Shih qëndrimin e Vanço Apostollskit, anëtarë i Kryesisë së KQ të LKM-së rreth kësaj çështje, me ç’rast ai këtë e sheh të dëmshme, ngaqë “rrenon raportet brenda njësisve federative si dhe kontekstet e tyre historike me shtetet amë”. (Lita, Qerim: “*Problemi Shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974*”, Shkup, 2018, libri i parë, faqe 60.)

<sup>1949</sup> Më gjerësisht rreth dënimit të një numri të madh të intelektualëve shqiptarë në Maqedoni nën akuzën “për veprimtari armiqësore që lidhej me kërkesën për republikën e përbashkët shqiptare në Jugosllavi”, shih Lita, Qerim: “*Çështja shqiptare në Maqedoni pas Brioneve*”, te Gjurmime Albanologjike, seria e shkencave historike, nr 37, Prishtinë, 2008, faqe 29-50.

është platforma dhe dokumentet partiake si dhe Kushtetuta, që duhet zbatuar me përkushtim”.<sup>1950</sup>

Hapja e këtyre temave si dhe reaksionet që kishin ngjallur ato, veçmas pas daljes në dritë të shumë e shumë keqpërdorimeve ndaj shqiptarëve në Kosovë dhe Maqedoni nga vitit 1948-1966, sidomos gjatë aksionit për mbledhjen e armëve në vitin 1956, pastaj ato që kishte shkaktuar edhe shpërngulja për në Turqi, me qendër Shkupin, në vitet 1951-1961, së cilës i kishte paraprirë edhe regjistrimi i popullsisë në Maqedoni i vitit 1953 me ç’rast me anën e metodave të dhunshme që ishin theksuar edhe në forumet më të larta partiake, një pjesë e mirë e shqiptarëve ishin deklaruar turq, kishte shtruar nevojën e hartimit të një platforme politike rreth qasjes së mëtutjeshme ideopolitike për barazinë e shqiptarëve me maqedonasit në RS të Maqedonisë në përputhje me faktet konkrete.

E faktet konkrete, flisnin qartë se shqiptarët në Maqedoni, nga viti 1948 e këndej, ishin diskriminuar nga shumë pikëpamjet. Por, diskriminimi më i madh, pa përjashtuar punësimin ku ata thuajse ishin sa për sy e faqe dhe në punët më të rënda,<sup>1951</sup> kishte qenë në planin kulturor dhe atë arsimor. Duke u mbështetur mbi konceptin e “pakicës”, veprimtaria kulturore e shqiptarëve duhej të rrudhej në disa shoqëri amatore, me programe kryesisht “të përziera”, e ku bënin pjesë edhe grupet e dramës dhe ato të recitatorëve. Degradimi në amatorizëm përfshiu edhe Dramën Shqipe në kuadër të Teatrit të Pakicave, të themeluar në vitin 1951, i cili, në vitin 1956, “për shkaqe financiare”u kthye “në teatër amator”.<sup>1952</sup>

Por, nga ajo që do t’i paraprijë platformës politike “Çështjet aktuale në realizimin e politikës së barazisë së kombësive në RS të Maqedonisë dhe aktiviteti ideopolitik i LKM-së”, e cila do t’i paraqitet Mbledhjes XIV të KQ të LKM-së, gjithsesi me rëndësi është Mbledhja VIII e përbashkët e Kryesisë dhe Komitetit Ekzekutiv të KQ të LKM-së mbajtur më 17 nëntor dhe 4 dhjetor 1976, meqë asaj mbledhje i ishte paraqitur një material voluminoz në të cilin përshkruhej procesi i zhvillimit të “kombësive shqiptare e turke”, nga këndvështrimi “i të arriturave” dhe pak apo shumë pak nga ana tjetër, e dobësive dhe problemeve, që tashmë ishin hapur në Plenumin e KQ të LKJ-së të Brioneve para një viti, për ç’gjë u sollën edhe konkluzione rreth keqpërdorimeve të shumta të organeve shtetërore

---

<sup>1950</sup> По аты.

<sup>1951</sup> Në vitin 1957, numri i përgjithshëm i shqiptarëve në Maqedoni ishte gjithsej 8.603, ndër ta vetëm 91 me kualifikime të larta, ndërsa pjesa e tjetër gjysmë të kualifikuar (2.395) dhe të tjerët të pakualifikuar, të punësuar në xeherore, ndërmarje ndërtimore dhe shërbime komunale.

<sup>1952</sup> ДАРМ.1.427.84.80/390-392 – Информација на Комисијата за национално малцинство, 27 мај 1958. Год. Скопје.

ndaj pakicave (në radhë të parë asaj shqiptare) si dhe u morën masa (largimi i Rankoviçit dhe bashkëpunëtorëve të tij nga posti i ministrit të policisë si dhe përjashtimi i tij nga forumet partiake).

Ndonëse, në këtë mbledhje, u theksuan “hapat pozitiv në drejtim të tejkalimit të vështirësive”, si dhe u vlerësua pozitivisht “klima e bashkëpunimit dhe mirëbesimit me udhëheqjen e Kosovës rreth programeve të përbashkëta që do t’i shërbenin afirmimit të mëtutjeshëm të vlerave kulturore të shqiptarëve, në mënyrë që ato të jenë në përputhje me frymën edukimit socialist vetëqeverisës”, megjithatë, në materialin e punës theksohet “se bashkëpunimi i shqiptarëve të RS të Maqedonisë me shqiptarët e viseve të tjera të Jugosllavisë”, te një pjesë e maqedonasve të shikohet me rezervë dhe të kundërshtohet, sepse sipas tyre “rrezikon kufijtë republikanë, respektivisht paraqet hapin e parë drejt përforcimit të separatizmit të shqiptarëve në Jugosllavi”, ndërsa në anën tjetër, shqiptarët, “këtë bashkëpunim e shikojnë si përpjekje për bashkimin mbarëshqiptar dhe në kushte të tilla shpalljen e një qendre që do të ishte meritore për zgjidhjen e çështjeve të shqiptarëve në Jugosllavi”.<sup>1953</sup>

Dukuria e dytë, pra që lidhet me “krijimin e një qendre shqiptare” në Jugosllavi iu referua “kërkesave gjithnjë e më të shpeshta të inteligjencies shqiptare për bashkimin politik-kulturor të shqiptarëve në Jugosllavi” në përputhje me kriteret e barazisë, me ç’rast u zu ngojë ajo që gazeta “*Rilindja*” e Prishtinës të jetë gazetë ditore për mbarë shqiptarët në Jugosllavi, ndërsa “*Flaka e Vëllazërimit*” të kthehet në të përjavshme me karakter kulturor.

Intonimit se kërkesa për krijimin e një qendre kulturore shqiptare, paraqet rrezik, iu kundërvu Gjoko Mitrev, i cili tha se “apriori nuk duhet vlerësuar si separatiste tendencat për krijimin e një qendre shqiptare”, ose edhe të dramatizohen kur ato shfaqen si masa për përmbushjen e nevojave të kombësive. Mitrev, pos tjerash, shfaqti habinë si është e mundur që kërkesa për botimin e “*Flakës së Vëllazërimit*” në të përditshme të kontestohet, kur ajo e drejtë u takon shqiptarëve dhe është deshtë ta kenë nga fillimet.<sup>1954</sup>

Mitrevi si dhe bashkëmendimtar i tij Katarxhievi,<sup>1955</sup> u kundërshtuan me të shpejtë nga Kërste Cërvenkovski. Kreu i partisë theksoi se druajtja nga “qendrës

---

<sup>1953</sup> ДАРМ.1.427.143. 5/171-213, fjala e Vanço Apostollskit te Lita, Qerim “*Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974*”, libri i parë, Shkup, 2018, faqe 63.

<sup>1954</sup> Po aty, fjalimi i Gjoko Mitrevit.

<sup>1955</sup> Anëtar i KQ të LKM-së Ivan Katraxhiev, duke kundërshtuar qëndrimin e Cërvenkovskit theksoi se “Ne përballë serbëve dhe kombeve të tjera, në këtë periudhë të deritanishme sillemi me inferioritet të caktuar, ndërsa përballë popullit shqiptar me një superioritet të dukshëm. Kjo, në fakt paraqet burim të përplasjeve nacionale, të cilat në periudha të caktuara të zhvillimit tonë socialist më pak ose më shumë qenë manifestuar,

shqiptare” ishte shqyrtuar edhe në takimin me komunistët nga Kosova dhe ishte vlerësuar si e dëmshme, ngaqë “nëse ne tani, lëshojmë ndonjë parullë shqiptarë bashkohuni, atëherë duhet ta kemi të qartë se ekzistojnë forca tjetra më të fuqishme, të cilat me parulla të ngjashme të kërcënohen, madje edhe në shpërbërjen e kësaj bashkësie jugosllave”.<sup>1956</sup>

Fryma që Cërvenkovski ia imponoi Plenumit Partiak në këtë mbledhje, zuri vend edhe në “Platformën” e KQ të LKM-së. Asaj do t’i bashkohen edhe Azem Zylfiqari dhe Hixhet Ramadani.

Kjo platformë, përkundër eufemizmave politike rreth barazisë, në të vërtetë përhap frikën nga barazia, me të cilën filluan të frenohen dy procese, që ishin inicuarngë Plenumin e Brioneve të qershorit të vitit 1966: avancimi i barazisë kombëtare në planin kulturor dhe arsimor si dhe në atë shoqëror dhe politik, me ç’rast të rëndësishme ishin masat që lidheshin me punësimin e shqiptarëve në përputhje me strukturën e tyre popullatave si dhe përfaqësimin në administratën shtetërore (gjyqësor, polici dhe armatë) ku ata ishin të diskriminuar.

Në këtë aspekt, të rëndësishme ishin edhe simbolet kombëtare dhe përdorimi i tyre, për të cilat, po ashtu, forumi më i lartë partiak jugosllav kishte dhënë dritën e gjelbër, por pritej që, në nivelet republikane dhe krahinore, ato të rregulloheshin me ligj. Te kjo çështje, në Maqedoni hetohej një hezitim i theksuar, që vazhdimisht arsyetohej me atë se “lejimi i përdorimit të flamurit shqiptar, në përjashtim të manifestimeve private, përbënte hap drejt krijimit të një qendre të vetme politike shqiptare në Jugosllavi”. Këtë e përlligji edhe Qeveria e Maqedonisë, me qëndrimin se flamuri kombëtar i kombësive shqiptare dhe turke mund të përdoret vetëm në raste private dhe jo në ato shtetëror.<sup>1957</sup>

Qëndrimet e ngjashme me të drejtë revoltuan shqiptarët e Maqedonisë, sidomos inteligjencien dhe studentët (shumë prej tyre vijonin studimet në Prishtinë), të cilët, filluan të krijojnë bindjen se pos disa ndryshimeve të vogla kozmetike, udhëheqja politike e Maqedonisë nuk dëshironte të ndiqte kursin e reformave të thella shoqërore dhe politike të iniciuara nga forumet më të larta partiake të Jugosllavisë nga Plenumi i Brioneve e këndej me të cilat parashihej përmirësimi i pozitës së shqiptarëve si dhe ndryshimi i statusit të tyre nga ai i pakicës së shkë-

---

mirëpo sot ato janë të dukshme dhe kanë dalë në sipërfaqe. (ДАРМ.1.427.142.20/237-403), nga Lita, Qerim: “*Problemi shqiptar në RR(S) të Maqedonisë 1944-1974*”, Shkup, 2018, libri i parë).

<sup>1956</sup> По аты.

<sup>1957</sup> ДАРМ.1.427.197.16/266-268.

putur te kombësia e ndërliður në hapësirën jugosllave në formën me një identitet të përbashkët shqiptar.

Në këto rrethana, ishte e pritshme që të ketë edhe reagime. Atyre u dhanë shtysë të madhe demonstratat e Kosovës, që u mbajtën në shumë qytete të Kosovës nga 5 nëntori (në Prizren, pastaj në Pejë, Istog, Ferizaj, Gjilan dhe Podujevë) dhe përfunduan më 27 nëntor në Prishtinë. Në këto demonstrata për herë të parë u nxor kërkesa për Republikën e Kosovës. Ndërsa në Prishtinë, në një rënë ndër demonstratat më të mëdha shqiptare që u mbajtën asokohe në ish Jugosllavi (morën pjesë mbi njëqind mijë veta), krahas parullës për Republikën e Kosovës, u paraqiten edhe disa kërkesa të tjera ndër të cilat më të theksuara ishin ato që shqiptarëve t'u njihej statusi i kombit, të përdorshin lirish simbolet kombëtare, dhe ajo që ishte më e rëndësishme ishte që Kosova të ketë universitetin në gjuhën shqipe.<sup>1958</sup>

Në demonstratat e Prishtinës morën pjesë një numër i madh studentësh shqiptarë nga Maqedonia që studionin në fakultetet e Prishtinës si dhe intelektualë shqiptarë nga Shkupi, të cilët kohëve të fundit kishin filluar të bëheshin pjesë e qarqeve krijuese dhe intelektuale të përbashkëta.

Edhe pse përgjigja e organeve policore dhe e shtetit ishte e ashpër ndaj demonstruesve në Prishtinë (me këtë rast u vra i riu Valon Murati dhe shumë të tjerë u plagosën), megjithatë kjo nuk ndalin vrullin demonstrues që të përhapej edhe në Maqedoni. Kërkohej vetëm një shkas dhe ai jo rastësisht erdhi në Tetovë, mbrëmjen e 22 dhjetorit, nga një fotograf maqedonas (Sreçko Janevski),<sup>1959</sup> i cili hoqi me dhunë flamurin kombëtar të vendosur në lokalin e Ismail Ejupit, në afërsi të sheshit të qytetit.<sup>1960</sup>

Kjo kishte provokuar shqiptarët, të cilët, të revoltuar, vrapuan pas kryesit të veprës, i cili ishte strehuar në hotelin "Makedonija". Masa e grumbulluar kishte thyer xhamat e hotelit dhe më pas ishte drejtuar edhe për te dyqani i lokalit të Janevskit, të cilit i ishin thyer vitrinat e lokalit. Protestuesit ishin shpërndarë pas ndërhyrjes së organeve të rendit.<sup>1961</sup>

---

<sup>1958</sup>Më gjerësisht rreth demonstratave të Prishtinës të vitit 1968 shih: Novosella, *Selatin "Demonstratat e gjash-tëdhjetetës"* 1, 2, 3, Prishtinë, 2008; Buxhovi, Jusuf: *"Kosova"* I-V, Prishtinë, 2015, libri V, faqe 108-109.

<sup>1959</sup> Fotografi Janevski ishte ndër provokuesit maqedonas kundër përdorimit të flamurit shqiptar, i cili kishte dërguar një peticion te organet e shtetit për moslejimin e vendosjes së flamurit shqiptar. (Shih: Salihu, Salih: *"Ngajrje, dhe dëshmi – diskriminimi i shqiptarëve në Maqedoni"*, Tetovë, 2011, fq.63-66.)

<sup>1960</sup> Po aty.

<sup>1961</sup> Po aty.

“Fesati” i fotografit me heqjen e flamujve si dhe reagimet e protestuesve, megjithatë i kishin shërbyer një provokimi tjetër të organeve të rendit, të cilët, po atë mbrëmje, kishin arrestuar një grup intelektualësh shqiptarë, arsimitarë dhe mjek nga Tetova, të cilët kishin shkuar të protestonin te kryetari i komitetit komuna të Tetovës, Xhemal Veseli. Lajmi për arrestimin e tyre ishte përhapur me të shpejtë, gjë që në mëngjes, grupet e të rinjve shqiptarë ishin grumbulluar para dyqanit të fotografit Janevski dhe kishin filluar të brohorasin parulla kundër shovinizmit maqedonas, pastaj: “*Duam barazi*” dhe “*Rroftë Fadil Hoxha*”, e të tjera. Masa e tubuar së shpejti kishte lëvizur në drejtim të qendrës së qytetit. Asaj i ishin bashkuar nxënësit e gjimnazit “Kiril Pejçinovski” dhe qytetarë të tjerë. Disa qindra demonstrues kishin hyrë brenda ndërtesës së Komitetit Komunal të LKM-së dhe kishin vendosur dy flamuj kombëtar. Masa e madhe e demonstruesve, duke lëvizur rrugëve kryesore, kishte thyer disa dyqane dhe disa vetura, kishte hyrë në ndërtesën e Kuvendit Komunal, por pa shkaktuar asnjë dëm.<sup>1962</sup>

Demonstratat kishin përfunduar në orët e vona, por veprimet e organeve të rendit kishin filluar pasi që ishin shpërndarë demonstruesit. Njësi të shumta policoresh nga Shkupi dhe pjesët tjera kishin filluar bastisjet dhe burgosjet e demonstruesve, shumë prej tyre intelektualë kritikë të përfshirë në debatet publike dhe ato politike rreth gjendjes në Maqedoni, që kishin kërkuar ndryshimin e saj sa më të shpejtë.<sup>1963</sup>

Burgosjet dhe masat represive nga Tetova ishin zgjeruar në Shkup, Strugë, Dibër, Gostivar dhe vende të tjera të banuara me shqiptarë. Shumë intelektualë, arsimitarë dhe studentë u burgosën me akuzën “e veprimtarisë armiqësore”. Krahas burgosjeve, arrestimeve që përfundonin me shqiptimin e dënimeve të shumta nga ato për kundërvajtje (30 ditë) deri te a to penale nën akuzën “për veprimtari armiqësore kundër shtetit e popullit” (nga 1 deri në shtatë vite),<sup>1964</sup> u hap edhe një proces diferencues në arsim, me ç’rast, nën anatemën e “papërshtatshmërisë ideore-politike”, shumë mësues dhe arsimitarë u larguan nga procesi arsimor.

Masat represive ndaj demonstruesve si dhe zgjerimi i tyre në pjesët tjera të vendit, ku dyshimi “për veprimtari armiqësore” ishte kthyer në një kartë me të

---

<sup>1962</sup> Po aty.

<sup>1963</sup> Sipas burimeve zyrtare, me rastin e demonstratave të Tetovës, ishin arrestuar një numër madh demonstruesish, ndaj 153 syresh ishin marrë masa represive. 46 prej tyre ishin punëtorë të arsimit, 34 studentë, 11 nxënës, 27 punëtorë, 10 bujq e të tjerë. Penalisht ishin ndekur 13 arsimitarë, 2 mjekë, 3 studentë, 7 punëtorë, dy zejtar, 2 nëpunës dhe 3 nxënës. (Lita, Qerim: “*Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974*”, libri i parë, Shkup, 2018, faqe 73.)

<sup>1964</sup> Gjykata e Shkupit, brenda një kohe të shkurtër kishte denuar me burg të rëndë në kohëzgjatje prej 1 deri në 7 vjet 31 veta, kryesisht arsimitarë dhe intelektualë. (ДЈАРМ.1.427.197.39/714-721).



cilën mund të ndiqeshin gjithë ata që shtronin kërkesa për barazi dhe kundër diskriminimit prej vitesh, realitet ky që ishte gjykuar edhe në Plenumin e Brionëve, shtoi pakënaqësitë në Kosovë, po edhe viset tjera të vendit.

Me kritika të hapura ndaj asaj që tashmë dilte si “fushatë ndaj intelektualëve shqiptarë” në Maqedoni, u shfaq edhe në pjesë e shtypit jugosllav nga Zagrebi dhe Lubjana. U kërkua që udhëheqja më e lartë politike dhe shtetërore e vendit, e cila me të drejtë kishte ngritur çështjen e diskriminimit të shqiptarëve në Kosovë, Maqedoni dhe pjesët tjera të vendit dhe për këtë kishte marrë masa partiake dhe shtetërore ndaj udhëheqësve të caktuar të vendit (shkarkimi i Rankoviçi dhe Stefanoviçit dhe një pjese të aparatit policor), të harmonizojë qëndrimet lidhur me kriteret e barazisë kombëtare në mënyrë që të mos ketë shpërputhje midis vlerësimeve të Prishtinës dhe Shkupit rreth asaj çfarë është e drejtë nacionale dhe “veprimtari armiqësore”.<sup>1965</sup>

Kjo bëri që edhe Fadil Hoxha, anëtarë i Kryesisë së KQ të LKJ-së, në Beograd të ngrehë zërin kundër “kursit shumë të ashpër” që ndiqej në Shkup ndaj demonstruesve, në vend se të zbatoheshin qëndrimet e forumeve më të larta partiake dhe shtetërore për barazinë. Bëhet e ditur se në takimin e Beogradit, lideri partiak maqedonas K. Cërvenkovski, jo vetëm që kishte mbrojtur kursin e Maqedonisë, por me ato që kishte thënë se “demonstratat në Kosovë qenë vlerësuar në mënyrë shumë të butë”, dhe se “shumë pak njerëz qenë arrestuar dhe shumica e tyre u dënuan me kundërvajtje”, e “kishte kthyer topin” në anën e kundërt. Cërvenkovski, po ashtu kishte deklaruar se në Maqedoni “policia i burgosi shqiptarët jo vetëm në Tetovë, por në mbarë Maqedoninë Perëndimore për veprimtari armiqësore kundër shtetit dhe popullit”.<sup>1966</sup>

Këto dhe qëndrimet e ngjashme, që gjithnjë e më shpesh vinin nga Serbia dhe Maqedonia, kishin detyruar Titon dhe bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë, që në Kongresin IX të LKJ-së, në mars 1969 të ritheksojë çështjet e barazisë së kom-beve dhe të kombësive si “detyrë e të gjithëve” (duke filluar nga qasja kritike e deri te platformat e përbashkëta).<sup>1967</sup> Me këtë rast, jo rastësisht, Tito kishte quajtur “të drejta” tri nga kërkesat që ishin shfaqur në demonstratat e Prishtinës të 27 nëntorit 1968:

- të drejtën për përfaqësim e Kosovës sa më adekuat në federatë;
- zhvillimin sa më të shpejtë ekonomik të Kosovës dhe

<sup>1965</sup> “Vjesnik”, Zagreb, 22 qershor 1969.

<sup>1966</sup> Lita, Qerim: “Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974”, libri i parë, Shkup, 2018, faqe 74.

<sup>1967</sup> “IX Kongres Saveza Komunist Jugoslavije”, “Komunist”, Beograd 1969, faqe 86-87.

- të drejtën e përdorimit të simboleve kombëtare (flamurit) për të cilat duhet të nxirren dispozitat e qarta.<sup>1968</sup>

Qëndrimet e Kongresit IX të LKJ-së rreth avancimit të barazisë së kombeve dhe të kombësive, me theks të veçantë te drejta për një identitet të përbashkët kulturor dhe arsimor në nivel të vendit si dhe konkluzionet me të cilat kërkohet avancimi i pozitës kushtetuese të Kosovës në federatë, kishin pasur efekte pozitive në tri drejtime: kah Beogradi – që të pranojë ndryshimin e pozitës kushtetuese të Kosovës në federatë, gjë që nënkuptonte që në përputhje me qëndrimet e Kongresit IX të LKJ-së të hartoheshin amendamentet me të cilat Kuvendi i Serbisë do t’ua hapte rrugën raporteve të reja Kosovë-Serbi në drejtim të Federatës (ku përjashtohet kërkesa për republikën e Kosovës, por assesi pozita e saj si njësi federative e barabartë me të tjerat); kah Prishtina – që kërkesa për republikën e Kosovës të refuzohet, por pa u quajtur kundërrevolucionare, siç kërkonte Serbia dhe Maqedonia, dhe në vend të saj të shfaqej kërkesa për përfaqësim të barabartë në federatën jugosllave, ndryshim ky që nënkuptonte që nga pikëpamja institucionale Kosova me universitetin në gjuhën shqipe si dhe institucionet shkencore të krijonte identitetin e vet kulturor, arsimor vetëqeverisës-socialist, që nuk mund të ishte tjetër pos shqiptar, dhe kah – Shkupi, që barazia e shqiptarëve të ketë dy linja: njërën në Maqedoni (në arsim, kulturë, inkuadrimi dhe përfaqësimin e barabartë në administratën republikane), ndërsa tjetrën në drejtim të një marrëveshjeje të ndërsjellë me Kosovën rreth bashkëpunimit në arsim dhe kulturë, që kjo t’i ndihmojë identitetit të përbashkët shqiptar në hapësirën jugosllave, ku Prishtinës, do t’i takojë përgjegjësia që kjo të jetë në frymën e bashkëjetesës së kombeve dhe të kombësive të Jugosllavisë dhe barazisë së tyre në përputhje me karakterin e një shoqërie vetëqeverisëse socialiste.

Gatishmëria e Titos që pas qërrimit të hesapeve me fraksionin etatist-burokrtik të Rankoviçit, kursi i reformave të paralajmëruara shoqërore dhe ekonomike të ecte rrugës së duhur në mënyrë që të fitonte modeli i vetëqeverisjes socialiste, të përcillej edhe me ndryshimin e pozitës kushtetuese të krahinave (Kosovës dhe të Vojvodinës në federatë) me çka asaj i ndryshonte karakteri, kërkonte edhe ndryshimin e pozitës kushtetuese të shqiptarëve në Jugosllavi, që nënkuptonte se

---

<sup>1968</sup> Buxhovi, Jusuf: “Kosova” I-V, Prishtinë, 2015, libri V, faqe 108-109 dhe Bilandžić, Dušan: “Povijest izbliza. Memoarski zapisi 1945-2005”, Zagreb, 2006.

edhe si kombësi, duhej të kishin “amzën identitare”, që nuk mund të ishte tjetër pos Kosovës,<sup>1969</sup> u kuptua drejt në Serbi dhe veçmas në Maqedoni.

Por, të kuptuarit “e drejtë” të avancimit të pozitës kushtetuese të Kosovës në federatën jugosllave, siç ishin ato në zhvillim e sipër dhe epilogun e tyre do ta marrin në Kushtetutën e Jugosllavisë të vitit 1974, nuk ishte vetëm çështje e raporteve të brendshme. Ato shfaqeshin edhe si pjesë e strategjisë së Titos në raport me Shqipërinë dhe zhvillimet e atjeshme, me të cilat prekeshin çështjet gjeostrategjike dhe gjeopolitike rajonale dhe më gjerë, ku Titoja, si lider i bllokut të painkuadruar midis blloqeve antagonistë (NATO-s dhe Paktit të Varshavës), ishte shumë i interesuar që Shqipëria e cila, edhe zyrtarisht kishte dalë nga Pakti i Varshavës pas ndërhyrjes së BRSS-së në Çekosllovakia në vjeshtën e vitit 1968, të mbetet “neutrale”, pra jashtë pranisë ushtarake sovjetike. Meqë lidhjet politike dhe ekonomike të Shqipërisë me Kinën nuk mund të prodhonin kurrfarë pasojash ushtarake, Titoja, njëherësh synonte që largimi ushtarak i Shqipërisë nga BRSS-ja të përcillej edhe me një zbutje të komunizmit dogmatik, që për alternativë mund të kishte vetëqeverisjen jugosllave, si një model liberal shoqëror dhe politik, që gëzonte gjithnjë e më shumë mbështetje midis vendeve të painkuadruara si dhe socialdemokracie perëndimore. Për këtë arsye, Tito vlerësonte se avancimi i pozitës së Kosovës në federatë si dhe afirmimi i mëtutjeshëm i shqiptarëve në Jugosllavi në planin ekonomik, arsimor dhe kulturor, ku Prishtina me universitetin në gjuhën shqipe dhe institucionet tjera shkencore dhe kulturore dukshëm më të avancuara nga ato të Shqipërisë, praktikisht kthehej në një qendër të rëndësishme të shqiptarëve në Jugosllavi, mund të ndikonte që Shqipëria, në rrugën e daljes nga izolimi komunist dhe dogma staliniste, mundësisht t’i kthehej modelit vetëqeverisës jugosllav, për ç’gjë Kosova dhe pozita e shqiptarëve do të mund të shfrytëzohej si një urë lidhëse.<sup>1970</sup>

---

<sup>1969</sup> Rreth Kosovës si “amzë identitare” e shqiptarëve të Jugosllavisë dhe rëndësisë së saj për raportet e ardhshme në federatën jugosllave pas Titos, ku Maqedonia fokusohet si pikë neuralgjike e krizës, ngaqë e dirigjuar nga Serbia, nuk do të jetë në gjendje të përballojë këtë test, shih: Strhöm, Karl Gustav: “*Ohne Tito, kann Jugoslawien überleben?*“, Wien, Graz, Köln 1976 dhe Meier, Viktor: „*Wiewurde Jugoslawien verspielt?*“, München, 1995.

<sup>1970</sup> Rreth qëllimeve që kursi i njohur i afrisë së Jugosllavisë me Shqipërinë nëpërmes Kosovës të shfrytëzohej për raportet e reja midis dy shteteve, me ç’rast politikanëve shqiptarë nga Kosova u binte detyra që të ndikonin në to, e vërteton edhe *Mahmut Bakalli*, lider komunist nga Kosova, bashkëpunëtor i ngushtë i Titos në vitet e shtatëdhjeta. Në një bisedë me publicistin e njohur gjerman Viktor Meier për gazetën “*Franfurter Allgemeine*”, në nëntor 1978, pos tjerash, thoshte se “Titoja llogariste se pas daljes së Shqipërisë nga pakti i Varshavës duhej të ndimohej me të gjitha mënyrat, që të largohej nga izolimi dhe kursi radikal stalinist.” Për Titon ishte e rëndësishme që zhvillimi i Kosovës si dhe avancimi i pozitës së saj në nivel të federatës jugosllave si dhe në përgjithësi përmirësimi i pozitës së shqiptarëve në Jugosllavi, të kthehej në një urë afrie midis dy vendeve. Bakalli thotë se Titoja personalisht kishte kërkuar që Kosova të merrte përsipër këtë rol, dhe se

Ky orientim i Titos për Shqipërinë, në njëfarë mënyre ishte kompatibil edhe me disa shtete perëndimore evropiane, sidomos me Gjermaninë Federale dhe Francën, të cilat ishin shumë të interesuara për një Shqipëri ushtarakisht neutrale, që do ta ndihmonin pa rezervë ekonomikisht, por që nuk ia kishin dalë që të vendosnin ndonjë bashkëpunim ekonomik me Tiranën, ngaqë Shqipëria, me anatemën e njohur ideologjike, edhe më tutje refuzonte çfarëdo kredie apo programi zhvillimor që mund t'i vinte nga perëndimi. Për Bonin dhe Parisin, Jugosllavia dhe Titoja, ishin një atu e mirë që barrierat ideologjike të bashkëpunimit ekonomik me Shqipërinë “të zbuteshin” disi nëse kalonin nëpërmes Beogradit në formën e një “partneriteti të veçantë” midis dy shteteve, të cilat dikur kanë qenë shumë të afërta dhe pranë një bashkimi madje.<sup>1971</sup>

Meqë komponenta e afri së mundshme të Shqipërisë me Perëndimin, do të mund të ndërlihej me agjendën e bashkëpunimit të Shqipërisë me Jugosllavinë, siç kishte filluar në të vërtetë në fushën e arsimit dhe të kulturës, në këtë frymë, Titoja autorizoi udhëheqjen e Kosovës që të kërkonte bashkëpunim sa më të gjërë me Shqipërinë jo vetëm në planin arsimor, kulturor dhe ekonomik, por edhe në atë ekonomik, me ç'ka Kosovës do t'i lejohej që të kthehej në një referencë të vetme të konventave të drejtpërdrejta me Shqipërinë si dhe marrëveshjeve të gjithëmbarshme nga ato kulturore, arsimore e deri të bashkëpunimi ekonomike të niveleve shtetërore.<sup>1972</sup>

Të tilla ishin ato për bashkëpunimin arsimor midis Universitetit të Prishtinës dhe Tiranës, shkëmbimit të kuadrove universitare, projekteve të përbashkëta humluese dhe shkencore, manifestimet e përbashkëta të niveleve kombëtare (shënimi i 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut, Konventa e Drejtshkrimit, shënimi i 100 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit me inaugurimin e Shtëpisë Memoriale të Lidhjes në Prizren në vitin 1978, botimet e përbashkëta të librave, shfaq-

---

për këtë i kishte ofruar mbështetje të plotë nga “keqpërdorimet” që mund të shfaqeshin në këtë drejtim nga kundërshtarët e këtij kursi. Në pyetjen se ai ishte “vetëqeverisja jugosllave opion i mundshëm për një Shqipëri dogmatike-staliniste kur E. Hoxha kishte botuar edhe një libër që atë e quante formë e revizionizmit modern”, Bakalli thoshte “se ishin të rëndësishme realitetet dhe jo propaganda, që do ta përcaktonin kursin e kthesave pozitive në Shqipëri ngaqë Shqipëria kishte ardhur në një gjendje që duhej të dilte nga kollapsi në të cilën gjendej, në të kundërtën rrezikonte një puç të brendshëm nga përkahësit sovjetik në Tiranë, që ishin të shumtë dhe llogarisnin që ajo serish t'i kthehej Moskës, gjë që për Jugosllavinë e painkuadruar dhe rajonin në përgjithësi paraqiste një rrezik të madh”. (Shih: Meier, Viktor “*Wie Jugoslawien verspielt wurde*”, München, 1995, faqe 56-57).

<sup>1971</sup> Po aty.

<sup>1972</sup> Nga biseda e autorit me *Mahmut Bakallin* në Prishtinë, në maj 2002. Sipas, Bakallit, Titoja, kërkonte nga udhëheqja e Kosovës që të krijonte të gjitha rrethanat për një bashkëpunim sa më të gjërë me Shqipërinë, pa u futur në polemika rreth kurist ideologjik të Shqipërisë dhe sulmeve që Enveri herë pas herë ndërmerre ndaj kursit vetëqeverisës dhe “revizionizmit” jugosllav.

jet e përbashkëta teatrore dhe të koncerteve si dhe ekspozitat nga arti dhe të tjera), krijoheshin rrethanat me të cilat objektivisht krijimtaria dhe kultura shqiptare në Jugosllavi, që kalonte nëpërmes Prishtinës me vulën e një tërësie, duke komunikuar me atë që krijohej në Shqipëri edhe të ndërlidhet në plan kombëtar. Kështu, bashkëpunimi i ndërsjellë në fushën e arsimit dhe të kulturës, krijonte rrethana që edhe ndarja ideologjike dhe ajo shtetërore midis dy vendeve të përballohej me një bashkëpunim të ndërsjellë. Për këtë arsye, Titoja kishte kërkuar që Prishtina e as Beogradi të mos hynin në polemika politike me Tiranën, të cilat, edhe përkundër bashkëpunimit të mirë, edhe më tutje ruanin antonimet kundër vetëqeverisjes jugosllave dhe kundër Titos dhe “kursit revizionist” të tij.<sup>1973</sup>

Në këto rrethana, kur Prishtinas dhe Kosova në raportet e brendshme po edhe ato të jashtme, veçmas me Shqipërinë fitonin një peshë të re, politikanët maqedonas, ndër ta Cërvenkovski dhe rrethi i tij, që vendimet e plenumit të Brionëve rreth “avancimit të pozitës së shqiptarëve” kishin filluar t’i interpretojnë si “rrezikim i Jugosllavisë” me arsyetimin se “krijimi i një qendre udhëheqëse” (mendohej te Kosova) hapte çështjen e Republikës shqiptare në Jugosllavi, e cila tashmë ishte “promovuar” me kërkesën për Republikën e Kosovës që kishte dalë në demonstratat e Kosovës të nëntorit 1968, iu kthyen “kursit të avancimit të pozitës së kombësive”, në mënyrë që tabloja për Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi të dalë në pamjen që ia kishte paraparë Titoja në kuadër të planeve të tij gjeopolitike dhe gjeostrategjike të koncepteve globale. Dhe, siç kishte ndodhë në vitet e dyzeta me krijimin e partisë komuniste shqiptare në Shqipëri dhe tërheqjen e saj në botën lindore, edhe në vitet e shtatëdhjeta, politikës shqiptare në Tiranë dhe Prishtinë Titoja po ia luante levat kryesore, me të cilat do të ndikohet fati i Kosovës, po edhe i federatës jugosllave me te.

Kështu, në janar të vitit 1969, Kuvendi i RS të Maqedonisë, solli dhjetë amendamente kushtetuese, të cilat u bënë pjesë e Kushtetutës së Maqedonisë. Ndër këto amendamente, i rëndësishëm ishte ai XIV, me të cilën parashiheshin disa

---

<sup>1973</sup> Nga biseda me prof. *Pajazit Nushin*, në Prishtinë në vitin 203, asokohe nënkryetar i Këshillit Ekzekutiv të Kosovës, përgjegjës për raportet me Shqipërinë. Prof. Nushi konfirmon qëndrimin e kreut më të lartë partiak dhe shtetëror që marrëdhëniet me Shqipërinë (ato arsimore, kulturore, sportive dhe të tjera) të kalojnë nëpërmes Kosovës. “Kishim mbështetjen e qeverisë federative për çfarëdo marrëveshjeje me Tiranën”. Sipas profesor Nushit, në një bisedë që kishte Titoja me udhëheqjen me F. Hoxhën dhe M. Bakallin me rastin e qëndrimit “pro” gjuhës standarde që duhej ta mbanin përfaqësuesit e Kosovës në Kongresin e Drejtshkrimit në Tiranë në vitin 1972, pa ngurruar që në atë takim të bisedonin edhe me Enverin, kishte porositur që propagandës ideologjike nga Tirana, Prishtina t’i kundërpërgjigjej me filma në gjuhën shqipe, me drama në gjuhën shqipe në Televizionin e Prishtinës si dhe me mbajtjen e simpoziumeve shkencore në të cilat do të trajtohen objektivisht çështjet e historiografisë dhe të gjuhësisë shqiptare jashtë dogmës ideologjike.

avancime të statusit të shqiptarëve dhe turqve: barazia gjuhësore në nivelet komunale, garantimi i zhvillimit të arsimit e të kulturës e të tjera.<sup>1974</sup>

Kuvendi i Maqedonisë solli edhe rezolutën me të cilën i obligonte organet dhe institucionet shtetërore t'i respektojnë në mënyrë konsekuente të drejtat e kombësisë shqiptare të garantuara me Kushtetutë,<sup>1975</sup> ku përfshiheshin: barazia gjuhësore, zgjidhja përfundimtare e problemit të arsimit shqiptar në Republikë, zhvillimi më i përshpejtuar i kulturës (kërkohej që Radio Televizioni i Shkupit të përfshijë programe në gjuhën shqipe e turke), pastaj “Flaka e Vëllazërimit” të shpallet gazetë e përditshme, krijimi i kushteve të nevojshme për punën e Teatrit të Kombësive në Shkupit (ngritja e tretmanit nga ai amator në teatër profesionist), përdorimi i flamurit të kombësive, e të tjera. Në fund të Rezolutës thuhet se “Këshilli Ekzekutiv do të përkujdeset për zbatimin e detyrave”, dhe sipas nevojës, “do të caktojë drejtimin e punës së organeve drejtuese republikane në realizimin e dispozitave dhe qëndrimeve të përfshira në të”.<sup>1976</sup>

Ngërçi i vitit 1969, që e pat krijuar Cërvenkovski me pasuesit e tij, të ndikuar nga nëntoka politike e Beogradit, se barazia e shqiptarëve e rrezikonte Jugosllavinë, sidomos pikëpamjet e tij për “qendrën shqiptare” dhe “flamurin kombëtar si frymëzues të irredentizmit” e anatema të ngjashme, më në fund mori fund në tetor të vitit 1973, kur Këshilli Ekzekutiv i Maqedonisë, e miratoi tekstin e Propozimit të Ligjit për përdorimin e flamujve dhe vendosi që të njëjtin t’ia dërgojë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim. Kuvendi i Maqedonisë, në seancën e 12 nëntorit 1973, e votoi ligjin.<sup>1977</sup>

Në nenin 6 thuhej: “përfaqësuesit e kombësisë shqiptare e turke, lirisht mund të përdorin flamurin e tyre nacional, në të gjitha rastet që është paraparë përdorimi i flamurit të RSM-së”.<sup>1978</sup>

## NDRYSHIMET KUSHTETUESE TË VITIT 1974 DHE VRULLI I EMANCIPIIMIT KOMBËTAR I LIDHUR ME KOSOVËN

---

<sup>1974</sup> ДАРМ.1.158.184.17/388-399 – Уставни Амандамани Собранието на Социалистичка Република Македонија.

<sup>1975</sup> Lita, Qerim: “Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974”, libri i parë, Shkup, 2018, faqe 74-75.

<sup>1976</sup> По аty.

<sup>1977</sup> По аty. Faqe 75.

<sup>1978</sup> По аty.

Ndryshimet kushtetuese të vitit 1974, të tretat me radhë nga krijimi i Jugosllavisë së AVNOJ-it, ndryshoi edhe raportet e bartëseve të sovranitetit shtetëror në nivelin federativ, atë të republikave dhe të krahinave (krahinat shfaqeshin si elemente konstituive të federatës jugosllave), ku kategoria e deritanishme klasore “popull punonjës”, zëvendësohej me “komb”, ndërsa “pakica kombëtare” definohej “kombësi”.<sup>1979</sup>

Ky kategorizim kushtetues kishte të bënte me të drejtën “e vetëvendosjes deri në shkëputje” të republikave që kishin republikat në raport me federatën e që rridhte nga vetëvendosja e kombeve, të cilën nuk e kishin kombësitë, nga që kishin “shtetin amë”.

Në përputhje me kushtetutën e RFSJ-së, preambula e së cilës atë e definonte si “shtet të kombeve dhe të kombësive të barabarta”,<sup>1980</sup> edhe Republika Socialiste e Maqedonisë definohej shtet kombëtar i popullit maqedonas, por në preambulën e saj Republika definohej “shtet nacional i popullit maqedonas”, por edhe “shtet i kombësisë shqiptare dhe turke në të”.<sup>1981</sup>

Kështu, Kushtetuta e vitit 1963 si dhe kushtetuta e vitit 1974 avancuan statusin juridiko-kushtetues të shqiptarëve në Maqedoni. Përcaktimi i tyre si subjekt konstituiv i Republikës Socialiste të Maqedonisë së bashku me popullin maqedonas, pos tjerash, u hapi rrugën dy zhvillime të rëndësishme:

*-përfaqësimit të tyre në organet shtetërore dhe*

*-forcimit të të drejtave kolektive në këtë republikë.*

Nga këto ndryshime, siç u pa, gjithsesi se më të dukshmet ishin ato në planin arsimor dhe kulturor, që shprehen me një përfshirje të lartë të shqiptarëve në të gjitha shkallët e arsimit nga ai fillor deri te universitari si dhe zgjerimi i veprimtarisë kulturore (botimi i librave në gjuhën shqipe, nga ato letrare e deri te shken-coret), zgjerimi i shtypit si dhe programeve shqipe në radio dhe televizionin shtetëror. Të dhënat zyrtare tregojnë se në vitet e shtatëdhjeta, mësimi në gjuhën shqipe zhvillohej në 211 shkolla fillore, ku përfshiheshin 45.931 nxënës dhe në 78 shkolla fillore me klasa të veçanta me mësim në gjuhën shqipe me 28.471 nxënës.<sup>1982</sup>

---

<sup>1979</sup> Shih “Kushtetuta e RFSJ-së 1974”, Rilindja, Prishtinë, 1974. Neni 1, faqe 3.

<sup>1980</sup> Po aty.

<sup>1981</sup> Shih preambulën e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, neni 1:

“Republika Socialiste e Maqedonisë është shtet nacional i popullit maqedonas dhe shtet i kombësisë shqiptare dhe turke në të, bazuar në sovranitetin e popullit, pushtetit dhe vetëqeverisjes së klasës punëtore dhe të gjithë njerëzve punonjës dhe bashkësisë socialiste demokratike vetëqeverisëse të popujve punonjës dhe qytetarëve, të popullit maqedonas dhe me të të barabartë të kombësisë shqiptare dhe turke”

<sup>1982</sup> Shih: Starova, Vullet: “Jeta e përbashkët – kombësia shqiptare në RS të Maqedonisë”, “Komunist”, Shkup, 1988.

Në shkollimin e mesëm të orientuar, po në vitin shkollor 1979/1980, mësimi në gjuhën shqipe zhvillohej në 17 shkolla të mesme, në të cilat me 26 drejtime profesionale përfshiheshin 8.226 nxënës.<sup>1983</sup>

Në sistemin arsimor në gjuhën shqipe të të gjitha niveleve ishin të përfshirë mbi 4000 arsimtarë dhe profesorë shqiptarë.

Krahas përfshirjes së fëmijëve shqiptarë në shkollat fillore dhe ato të mesme me mësim në gjuhën shqipe, një pjesë e mirë e atyre që kryenin shkollat e mesme, studimet në gjuhën shqipe i ndiqnin në Akademinë Pedagogjike dhe në Fakultetin Filologjik në Katedrën për Gjuhë dhe Letërsi në Shkup. Ndërsa, në Universitetin “Kirili dhe Metodi”, ishin përfshirë 698 studentë shqiptarë.<sup>1984</sup>

Por, numri më i madh i atyre që vazhdonin studimet universitare dhe pasuniversitare në gjuhën shqipe përfshiheshin në Universitetin e Prishtinës, zhvillim ky që do të ketë rëndësi të madhe për raportet kulturore, arsimore dhe politike të shqiptarëve në hapësirat e Jugosllavisë. Në vitin 1979/1980, në Universitetin e Prishtinës, nga Maqedonia studionin mbi 5000 studentë shqiptarë, që përbënte një të pestën e numrit të përgjithshëm në universitetin më të madh shqiptar në Ballkan.

Në vazhdën e këtyre ndryshimeve pozitive, shfaqen edhe raportet Maqedoni-Kosovë. Bashkëpunimi i deri i atëhershëm ekonomik, i mbështetur në rporte thuajse koloniale (furnizimi i Maqedonisë Hekuranës së Shkupit me energji elektrike nga Kosova me çmime “të garantuara” dukshëm nën nivelin e atyre të tregut të vendit si dhe me minerale, nga Trepça, si lëndë e parë, që përpunoheshin në Maqedoni), po ia lëshonte vendin marrëveshjeve mbi të cilat funksiononte ekonomia e tregut mbi bazat e planifikuara nga marrëveshjet e përbashkëta. Politika e shkëmbimeve të balancuara ua hapi rrugën mallrave të Kosovës për në tregjet e Maqedonisë, me ç’rast u shfaqen edhe lidhjet kooperuese në të dy anët, ndërmarrjet e përbashkëta, që u dhanë shtysë prodhimeve vendore si dhe përfaqësimit me prodhime të përbashkëta sidomos të atyre nga agrikultura në tregun jugosllavë dhe atë të jashtëm, për ç’gjë mbretëronte një interesim i madh brenda dhe jashtë vendit.

Ajo që më së shumti i dha hov të veçantë bashkëpunimit midis Maqedonisë dhe Kosovës ishte fusha e arsimit dhe e kulturës, me ç’rast Kosova, për shqiptarët e Maqedonisë, kthehet në “një amëz” identitare dhe me të drejtë madje, ngaqë historikisht, nga antikiteti, mesjeta dhe veçmas shqiptarizmi politik i shekullit kaluar, kishte qenë përherë e tillë. Natyrisht, kësaj kthese të madhe, shtysën më të

---

<sup>1983</sup> Po aty.

<sup>1984</sup> Po aty.



madhe ia jepte Universitetit i Prishtinës, si dhe roli i tij i jashtëzakonshëm në krijimin e kësaj vetëdije, që edhe nga politika jugosllave ishte pranuar zyrtarisht “universitet shqiptar” ndër më të fuqishmit në rajon.

Por, fluksi i madh i studentëve shqiptarë nga Maqedonia për në Prishtinë shënohet nga fillimi i viteve të gjashtëdhjeta, kur do të hapen fakultetet e para në gjuhën shqipe në Kosovë, ku u përcaktuan kuotat për studentët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Lugina e Preshevës, të cilat arrinin deri në 20 përqind të numrit të përgjithshëm. Në disa fakultete kjo ishte edhe më e madhe.

Me themelimin e Universitetit të Prishtinës, kuotat për studentët nga Maqedonia ruajtën nivelin deri në 20% në vit, gjë që në fakultetet e Universitetit të Prishtinës, numri i studentëve shqiptarë nga Maqedonia sillej në pesë mijë sosh.

Krahas regjistrimit të garantuar në të gjitha fakultet, Universiteti i Prishtinës si dhe institucionet shkencore, ishin përherë të hapura për studime pasuniversitare për ata që kryenin studimet në Prishtinë dhe përcaktoheshin për punë shkencore-hulumtuese. Me të kryer magjistraturat ose doktorantuarat një pjesë e mirë e të diplomuarve nga Maqedonia mbeteshin në Kosovës. Institucionet shkencore në Kosovë ofronin mundësi për punë shkencore dhe hulumtime të përhershme.

Studimet në Prishtinë, mbetja e një pjese të atyre që diplomonin në Kosovë, por edhe kthimi i tyre në Maqedoni, po krijonin rrethana reale që etnia shqiptare në Kosovë dhe në Maqedoni të ndërlidhej gjithanshëm me një identitet kombëtar që amortizonte edhe “limitet” që vinin nga “shoqëria socialiste”. Kësaj i ndihmonin raportet shumë të mira institucionale dhe politike midis Prishtinës dhe Shkupit të ndërtuara mbi konsensusin politik në federatën jugosllave, që kufijtë administrativ, çfarë ishin midis republikave dhe krahinave, nuk duhej të shfaqnin kurrfarë pengese për afirmimin e përbashkët brenda Jugosllavisë të kombeve dhe të kombësive të barabarta.<sup>1985</sup>

Përkundrazi, me platformën partiake që doli nga Kongresi X i LKJ-së në 1974, republikat dhe krahinat ishin të obliguara që siç ndodhte me “tregun e përbashkët jugosllav” në kuadër të ekonomisë vetëqeverisëse socialiste, ngjashëm të veprohej edhe me “kulturën, si vlerë të përbashkët të kombeve të të kombësive”, që duhej të qarkullonte shpirtshëm në gjithë hapësirën jugosllave, ku secila kulturë kombëtare njëherësh ishte edhe kulturë e përbashkët jugosllave, jo nga përqsasja ideologjike, por e qasjes së lirë në të për të gjithë.<sup>1986</sup>

---

<sup>1985</sup> Shih Platformën e Përbashkët të KQ të LKJ-së të dalë nga Kongresi X i LKJ-së në Beograd, gusht 1974. “Komunist”, Prishtinë 1974.

<sup>1986</sup> Po aty.

Në këtë model të lirë të kulturave të kombeve dhe të kombësive si dhe raporteve participuese-anticipuese me “tërësinë e përbashkët”, ndodhej edhe kultura e shqiptarëve në Jugosllavi, e cila “amzën” e vet institucionale po e ndërtonte në Kosovë, në Universitetin e Prishtinës dhe Institutet e saj (atë të Albanologjisë si dhe të Historisë).

Ky raport, që do të nxjerr një inteligjencë të përbashkët shqiptare në Jugosllavi, shënon një të arritur shumë të madhe të përbashkët të shqiptarëve në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe pjesët tjera ku ata jetonin dhe shfaqej identifikuese. Këtë e bënte qendra, pra Prishtina si dhe koncepti i përbashkët arsimor, kulturor, shkencor që i përshkonte ato, sidomos pas vendimeve të Kongresit të IX të LKJ-së në mars 1969, kur do të sillen konkluzionet për avancimin e pozitës së kombësive si dhe avancimin e pozitës së Kosovës në federatën jugosllave.

Këto zhvillime, që shkonin drejt një identiteti të përbashkët shqiptar në Jugosllavi, që për referencë kishte Kosovën, lëviznin drejt një rrjedhe të pandalshme, edhe përkundër reagimeve të herë mas hershme nga Beogradi, siç ishin ato që vinin nga akademikët serbë përreth Qosiqit,<sup>1987</sup> po edhe të një spektri politik serb, që doli me “*Librin e Kaltër*” në vitin 1979, e nuk mungonte edhe ndonjë “spicë” nga nëntoka e nacionalizmit maqedonas, ku duhej të testoheshin shumë nga veprimet e Beogradin ndaj shqiptarëve dhe Kosovës,<sup>1988</sup> së cilës iu dha përgjigje “diplomatike” nga vetë Titoja.<sup>1989</sup>

---

<sup>1987</sup> Shih fjalimin e Dobrica Qosiqit në Plenumin e VIII të KQ të LKS-së në qershor 1968 kundër autonomisë së Kosovës dhe “krijimit të unitarizmit shqiptar”, që vjen nga “lidhja shqiptare” midis Prishtinës dhe Shkupit në dëm të Serbisë dhe popullit serb, për ç’gjë Qosiq do të përjashtohet nga KQ iu LK të Serbisë, si dhe librin “*Stvarno i moguće*” (*E vërteta dhe e mundshmjia*), Budva, 1986, ku akademiku serb i aktivizon qendrimet e vitit 1968, duke e ngritur „rrezikun nga nacionalizmi shqiptar“ në një „platformë të Vatikanit dhe SHBA-ve kundër Serbisë dhe Jugosllavisë“!

<sup>1988</sup> Një “testim” i kësaj natyre që Shkupit i vinte nga Beogradi, ishte edhe “memoraja” e Limanovskit rreth “goranëve” dhe “torbeshëve” në Dragash dhe gjetiu në Kosovë, që ai i quante “maqedonë” të cilët “politika nacionaliste e Kosovës” kishte zënë t’i kthente “në shqiptarë”. Shkrimet të Limanovskit iu bë jehonë në mediat e Beogradit, të cilat kërkuan që në Maqedoni të pengohet “shqiptarizimi i goranëve dhe torbeshëve”. Me këtë rast, nga Kosova (Akademia e Shkencave të Kosovës dhe Instituti i Historisë), iu dha një përgjigje Limanovskit dhe gjithë asaj që lidhej me fushatën që në Maqedoni të pengohej deklarimi kombëtar.

<sup>1989</sup> “*Libri i kaltër*” u shfaq si “pjesë e një shqyrtimi kritik të një organizate partiake të Beogadit” ndaj faktorëve që e rrezikonin Jugosllavinë socialiste dhe vetëqeveriste, ndër të cilët, kryesori ishte pozita kushtetuese e Kosovës në kuadër të federatës jugosllave si dhe konsensusi në të, që duhej të shqyrtohej, në mënyrë që “Jugosllavia të mbrohej nga rreziku që i vinte nga separatizmi”! Natyrisht se ndaj këti dokumenti u reagu dhe Titoja në Karaxhorgjevë thirri një mbledhje “të mbyllur”, ku kreu politik i Serbisë u kritikua “për destrucion”. Drazha Mihajloviqi, njëri nga bashkëpunëtorët e Titos kërkoi falje, gjë që edhe dokumenti u tërhoq nga shqyrtimi i mëtuftjeshëm politik. Mbas vdekjes së Titos, në vitin, 1980, “*Libri i kaltër*” u aktivizua në shumë forma, për t’u kthyer në bosh të politikës hegjemoniste të Millosheviqit për rrënimin e autonomisë së Kosovës dhe të federatës jugosllave. (Shih: Buxhovi, Jusuf: “*Kosova*” I-V, 2015, libri V, faqe 172-178)

Hapësira e përbashkët kulturore shqiptare në relacionet Prishtinë-Shkup dhe anasjelltas, së cilës ia përcaktonte dinamikën Kosova, pasurohej me botime të autorëve shqiptarë në fushat e letërsisë, veprat e të cilëve, të shumtën të botuara nga “Rilindja” e Prishtinës po edhe ato nga “Flaka e Vëllazërimit” e Shkupit, të cilat depërtonin në rrjetet e përbashkëta librare, në biblioteka po edhe në të gjitha libraritë në të dy pjesët.

Gjithsesi binarët e bashkëpunimit ekonomik, arsimor dhe kulturor me Maqedoninë qëndronin te përcaktime politike, që sollën ndryshimet kushtetuese të fillimviteve të gjashtëdhjeta dhe ato të viteve të shtatëdhjeta, të cilat u përcollën edhe me reagime të shpeshta frenuese nga Beogradi dhe bashkëmendimtarët e tyre në radhët e politikës maqedonase, që i lidhte interesi i përbashkët i politikave antishqiptare, të cilat, përpiqeshin që këtë zhvillim ta pengonin me anatemat “e irredentizmit” dhe më vonë edhe të “separatizmit” që prodhonte kërkesa për Republikën e Kosovës në federatën jugosllave. Do theksuar me këtë rast, rol të rëndësishëm luajti klasa e atëhershme politike në Kosovë si dhe inteligjencia shqiptare në të dy anët, e cila hetoi çastin historik që ndryshimet që solli ky zhvillim të shfrytëzoheshin për avancimin e statusit shoqëror dhe politik në të gjitha sferat e jetës institucionale në mënyrë që të jetë e gatshme që të ballafaqoheshin me sfidat që vinin nga tik-taku biologjik i epokës së Titos, që si do të shihet, do të nxjerrë në pah recetat “e vjetra” antishqiptare, paçka se ato do ta sjellin edhe shkatërrimin e Jugosllavisë së Titos.

E vetëdijshme për këtë zhvillim të pashmangshëm si dhe përgjegjësinë që kishte kundruall tij, klasa politike e Kosovës në krye me Fadil Hoxhën, Veli Devën dhe Mahmut Bakallin, u angazhua drejtpërdrejtë që klima e re e krijuar pas Plenumit të Brioneve në qershor të vitit 1966 e këndeje të shfrytëzohet në dy binarë kompartabil të një rëndësie historike: në atë politik – që pozita kushtetuese e Kosovës, e filluar me amendamentet kushtetuese të vitit 1968, të avancohet në njësi federative, siç do të ndodhë në të vërtetë me ndryshimet në Kushtetutën e vitit 1974 ku do të fitojë statusin e njësisë së barabartë në federatën jugosllave, pozitë kjo që sanksiononte neni 1 i Kushtetutës jugosllave,<sup>1990</sup> dhe në binarin e emancipimit kulturor dhe arsimor, që me krijimin e institucioneve (universitetit të Prishtinës në gjuhën shqipe, i themeluar në vitin 1970, instituteve shkencore, Akademisë së Shkencave

---

<sup>1990</sup>Në Nenin 1, Republika Federative Socialiste e Jugosllavisë definohej federatë e përbërë nga gjashtë republika socialiste (Serbisë, Kroacisë, Bosnjes dhe Hercegovinës, Maqedonisë, Sllovenisë dhe Malit të Zi) dhe dy krahina autonome (Vojvodina dhe Kosova). Këto të fundit njëherësh janë edhe në përbërje të RS të Serbisë. (“Kushtetua e RFS të Jugosllavisë”, Prishtinë, 1974, faqe 2)

të Kosovës, Televizionit të Kosovës, ngritjes së “Rilindjes” në radhën e botuesve më të fuqishëm në Jugosllavi e të tjera), shqiptarët në Jugosllavi të barazoheshin kulturalisht dhe politikisht me popujt tjerë, barazi kjo që nënkuptonte edhe “qendrën shqiptare”, ose “amzën” që nuk mund të ishte tjetër pos Prishtinës.

Edhe pse udhëheqësit partiakë të Kosovës në organet federative (Fadil Hoxha dhe Veli Deva dhe pak më vonë Bakalli) përpiqeshin që ta anashkalojnë ose edhe “demantojnë” çfarëdo anatemi të Prishtinës “qendër e shqiptarëve në Jugosllavi”, praktikisht ajo po shndërrohej në të tillë, me çka ishin pajtuar “heshtazi” Tito, Kardeli dhe Bakariqi, ngaqë kjo i shkonte përshtati konceptit të tyre për një federatë të re jugosllave jashtë mbikëqyrjes së Beogradit, në të cilën Kosova dhe shqiptarët luanin faktorin kyç për balancimet e saj strategjike brenda dhe jashtë.<sup>1991</sup>

Kështu, në nivelet jugosllave, krahas atyre politike (si njësi federative), me të arriturat e shpejta dhe tepër të rëndësishme kulturore, intelektuale, informative, Prishtina kishte fituar referencën e qendrës së barabartë ndër tetë sosh sa kishte federata jugosllave, dhe se kur përmendej ajo, atëherë nënkuptohej “identiteti shqiptar”. Kjo pasqyrohej thuajse në të gjitha fushat e artit dhe të krijimtarisë, me ç’rast “Kosova filmi” prodhonte filma në gjuhën shqipe dhe me tema shqiptare, që shfaqeshin në konkurrencën jugosllave në festivalin e Puljes por edhe jashtë; TV Prishtina, në festivalet muzikore jugosllave merrte pjesë me këngëtarë shqiptarë në gjuhën shqipe. Gjuha shqipe, madje, përdorej edhe në manifestimet më të mëdha të vendit, duke përfshirë edhe spektaklin politik-jugosllav, manifestimin e 25 majtit, kur stafeta e rinisë, kryetarit Tito, nga përfaqësuesit e Kosovës, i dorëzohej me përshëndetje në gjuhën shqipe. Mund të thuhet se gjuha shqipe ishte kthyer në gjuhë zyrtare në Kosovë dhe në relacionet jugosllave edhe për faktin se dokumentet personale (letërnjoftimi, pasaporta dhe certifikatat e amzës) lëshohehin në gjuhën shqipe. Në këto dokumente, Kosova kishte kodin identifikues “K”, ndër tetë sa kishin njësitë federative.

Referencën e Kosovës si “qendër shqiptare”, që Titoja tashmë e kishte kovertuar për arsye gjeostrategjike dhe gjeopolitike në raport me Shqipërinë po edhe rajonin, kishte filluar ta kapërdijë edhe Maqedonia dhe madje “ta mbështesë” për faktin që në këto raporte të rëndësishme, “barra e shqiptarizmit” nga Shkupi t’i bartej Prishtinës, në mënyrë që kjo të mos e pengonte “identitetin ma-

---

<sup>1991</sup> Shih: Đilas, Milova: “Tito. Eine kritische Biographie”, Molden, Wien, 1980; Đilas, Miovan: „Jahre der Macht. Kräftepiel hinter dem Eisener Vorang: Memoiren 1945-1966“, Molden-S.Sewald, München, 1983; Strhöm, Karl Gustav: „Ohne Tito, kann Jugoslawien überleben?“, Bastei-Lübbe, Styua, Graz, Wien, Köln 1976; Bilandžić, Dušan: „Povjesti izbliza. Memoarski zapisi 1945-2005“, Zagreb, 1999.

qedonas”, që po të mbetej i tëri atje, do t’i kthehej “në konkurrencë” që madje edhe do ta “zbehte” në planin shtetëror. Kështu që, në vitet në vijim (nga 1974-1981), udhëheqja politike e Shkupit përkrahu të gjitha marrëveshjet kulturore dhe veçmas ato arsimore me Kosovën, me të cilat, pjesa më e madhe e studentëve shqiptarë nga Maqedonia të studionin në Prishtinë (mbi 5 mijë, që kishin vendet e rezervuara nga 30 mijë që kishin universiteti) në mënyrë që universiteti i Shkupit të ruajë “identitetin maqedonas”.

Për Maqedoninë e cila shihte rrezik nga shtimi i inteligjencies shqiptare atje, ishte e mirëseardhur dukuria e mbetjes së studentëve shqiptarë nga Maqedonia në Kosovë, pasi që të kenë kryer studimet e atje, gjë që kështu ndodhte në të shumtën e rasteve, paçka se ishte pikërisht ky faktor që Prishtinën e kthente në “qendër shqiptare”, për ç’gjë ishin të interesuar edhe intelektualët shqiptarë nga Maqedonia, ngaqë ajo formësonte identitetin e përbashkët shqiptar në Jugosllavi, duke i liruar nga pozita e “pakicës” së diskriminuar siç kishin qenë për vite të tëra në Maqedoni.

Si pjesë e hapësirës së përbashkët kulturore shqiptare, kultura e shqiptarëve në Maqedoni, zuri vend edhe në raportet e ndërsjella kulturore dhe arsimore me Shqipërinë nga vitit 1968 deri në vitin 1981, zhvillim ky që nuk mund të shihet jashtë strategjisë së Titos edhe në raport me Shqipërinë si dhe rolit të saj gjeostrategjik pas daljes së saj nga Pakti i Varshavës në vitin 1968, me rastin e ndërhyrjes së BRSS-së në Çekoslovak, ngaqë të dy shtetet sfidoreshin njësoj nga një ndërhyrje “internacionaliste” e Moskës, që do të mund të provokohej nga jashtë.

Në këtë aspekt, sinjalet e para për “rrezikun e përbashkët” nga ndërhyrja që nuk mund të ishte tjetër pos nga ajo sovjetike, që të rikthehej në Ballkan, erdhën nga vetë Shqipëria. Diplomatët shqiptarë në Beograd, në takime joformale sollën mesazhin e udhëheqjes më të lartë partiake dhe shtetërore shqiptare se “në situatën e re të krijuar me agresionin e BRSS-së, udhëheqja shqiptare vlerëson se realisht është cenuar sovraniteti dhe integriteti i RP të Shqipërisë; se janë të gatshmet t’i japin mbështetje Jugosllavisë me të gjitha mjetet, materiale, morale dhe ushtarake në rast agresioni ndaj Jugosllavisë”.<sup>1992</sup>

Mesazhe të ngjashme Jugosllavisë i erdhën edhe nga vetë Enver Hoxha, cili në vitin 1969, duke përkujtuar “luftën e përbashkët të popujve të Shqipërisë dhe të Jugosllavisë kundër okupatorit nazi-fashist”, shprehu dëshirën “për normali-

---

<sup>1992</sup> ДАМВнР.оп.27.а.е.3225.л.204-210.

zimin e marrëdhënieve me Jugosllavinë”. Nuk vonoi dhe Titoja në Podgoricë, shprehu dëshirën “për normalizimin e marrëdhënieve me Shqipërinë”.<sup>1993</sup>

Shkëmbimi i mesazheve midis E. Hoxhës dhe Titos, ndikuan që dy shtetet marrëdhëniet diplomatike t’i ngritin në nivel të ambasadorëve. Kjo ndodhi në shkurt të vitit 1971. Ndërsa në korrik të atij viti qeveria jugosllave dërgoi ambasadorin e vet, Jovo Peçinoviç në Tiranë, ndërsa dy muaj më vonë, në Beograd erdhi ambasadori shqiptar, Dhimitër Lamani.<sup>1994</sup>

Gjatë pritjes së ambasadorit jugosllav në Tiranë, Jovo Peçenoviç, nga kryeministri Mehmet Shehu, ambasadorit jugosllav do t’i bëhet me dije nga kryeministri i Shqipërisë “se qeveria e Shqipërisë, tashmë Jugosllavinë nuk e konsideron si rrezikun potencial” dhe se “shpresojnë për një bashkëpunim në rast të ndonjë agresioni të cilit do prej dy shteteve”.<sup>1995</sup>

Mesazhet pajtuese dhe afruese, duke iu referuar “ndihmës së ndërsjellë në rast agresioni nga jashtë” (mendohej te ai sovjetik), në relacionet jugosllavo-shqiptare, do të bëhen thuajse në vazhdimësi. Në vitin 1973, gjatë një takimi jo-formal midis Kryetarit të Këshillit Ekzekutiv të Kosovës, Ilija Vakiq dhe Adil Çaçanit – kryeministër i Shqipërisë, ky i fundit, i tha Vakiqit se “Shqipëria gjithnjë është e gatshme t’i ndihmojë Jugosllavisë kundër rreziqeve eventuale për pavarësinë e saj, nëse është e nevojshme edhe me ushtri”. Ngjashëm si Çaçani shprehet edhe Enver Hoxha, gjatë një fjalimi në nëntor 1974, duke dënuar dilemat rreth “fatit të Jugosllavisë pas Titos”.<sup>1996</sup>

Edhe Titoja, nga Prishtina, më 4 prill 1975, deklaroi se “siguria e Shqipërisë varet në masë të madhe nga siguria e Jugosllavisë” dhe nga “marrëdhëniet dhe bashkëpunimi i mirë me Jugosllavinë, me respektim të ndërsjellë të veçorive në pozitën e brendshme dhe ndërkombëtare të secilës nga të dyja palët”.<sup>1997</sup>

Nuk do të vonojë dhe Enveri nga Tirana, serish do t’i dërgojë mesazhe pajtuese Beogradit. Nga foltorja e Kongresit VII të PPSH (në nëntor 1976), E. Hoxha, këtë herë, duke e drejtuar gishtin nga Moska, thoshte:

”Në rast të ndonjë sulmi eventual të BRSS-së ose të ndonjë force tjetër kundër Jugosllavisë, populli shqiptar do të jetë bashkarisht me popujt e Jugosllavisë”.<sup>1998</sup>

---

<sup>1993</sup> ДАМВиР, оп.31, а.е.3550, л.201-207 te Lita, Qerim: „Çështja shqiptare në RSFJ 181-1990”, Shkup, 2014, faqe 44.

<sup>1994</sup> Tanjug, Beograd, 6 shkurt 1971 dhe 11 shtator 1971.

<sup>1995</sup> ДАРМ.1.159.236/1-10.

<sup>1996</sup> ДАРМ.1.159.332.29/1-12.

<sup>1997</sup> ДАМВиР, оп.31, а.е.3550/201-207, Beograd, аугуст, 1975.

<sup>1998</sup> ДАРМ.1.1326.6/1-15.

Në këtë frymë shfaqej edhe kryeartikulli i “*Zërit të Popullit*”, organ i PPSH-së, më 19 janar “Kërcënimet dhe nënçmimet sovjetike-bullgare nuk do të kenë sukses në Ballkan”. Aty, pos tjerash, thuhej:

“Ne i deklarojmë botës së Shqipëria asnjëherë nuk do të lejojë që vendi i saj t’i shërbejë trupave të huaja si bazë për të sulmuar Jugosllavinë dhe Greqinë dhe se gjithnjë do të jemi në anën e popujve të Jugosllavisë dhe të Greqisë në luftën për liri, pavarësi dhe sovranitet nacional. Prandaj, jo vetëm që nuk vjen kurrfarë kërcënimi nga Shqipëria, por përkundrazi, gjithnjë do t’u ndihmojmë”.<sup>1999</sup>

Në frymën e përmirësimit të marrëdhënieve politike dhe diplomatike midis Jugosllavisë dhe të Shqipërisë, me ç’rast mesazhet midis Titos dhe Enverit, përkujtonin “kohët e arta” të bashkëpunimit jugosllav-shqiptar 1944-1949, marrëdhëniet kulturore dhe ato arsimore midis Kosovës dhe Shqipërisë ishin shprehje e një dëshire të përbashkët për bashkëpunim përkundër dallimeve të mëdha ideologjike që vazhdonin midis dy vendeve si dhe propagandës politike të cilën Tirana e ruante në raport me vetëqeverisjen dhe revizionizmin. Protokollet për bashkëpunim që u nënshkruan në vitin 1968, atë 1971 dhe 1974, u fokusuan në sferën e arsimit, kulturës dhe te sportit, por nuk munguan edhe disa forma të lehta të shkëmbimeve tregtare. Në këto raporte Kosova shfaqej si bartës kryesore, po ku nuk mungonin edhe marrëveshjet kulturore dhe arsimore midis Shqipërisë dhe Maqedonisë, të cilat, rëndom ndiqnin ato me Kosovën dhe kishin për qëllim që shkëmbimi kulturor dhe arsimor midis dy vendeve t’i shërbente interesave të përbashkëta të shqiptarëve në Jugosllavi si dhe identitetit të tyre kulturor dhe nacional, siç qe Kongresi i Drejtshkrimit në Tiranë, i viti 1972 si dhe pranimi i standardit të gjuhës së përbashkët letrare shqipe për gjithë hapësirën etnike shqiptare (në të dy shtetet). Edhe këtu, gjuhëtarët shqiptarë nga Maqedonia ishin pjesë e grupit të përbashkët të gjuhëtarëve shqiptarë nga Jugosllavia, të cilët u përfaqësuan në Kongres dhe ndihmuan për arritjen e marrëveshjes së përbashkët.

---

<sup>1999</sup> Po aty.

## KAPITULLI I TRETË

### MAQEDONA DHE KOSOVANË VITET 1981-1991

#### DEMONSTRATAT E VITIT 1981 DHE KTHIMI I POLITIKËS ANTISHQIPTARE

Raportet shoqërore dhe politike në nivelet jugosllave që sollën ndryshimet kushtetuese të vitit 1974 si dhe avancimi i pozitës së Kosovës në federatën jugosllave si njësi ndër tetë të barabartat me konsensus, ndonëse ndryshuan dukshëm pozitën e federatës jugosllave drejt transformimit të saj në një shoqëri vetëqeverisëse socialiste të një modeli liberal, megjithatë në planin politik ajo po mbërthehej nga një ngërç i brendshëm, që sa vinte e shtohet me shfaqjen e një sëmundje të rëndë (gangrena), që e kishte përfshirë Titon nga mesi i vitit 1979 dhe ai tashmë gjendej në një spital të Lubjanës, ku edhe më 5 maj të vitit 1980 vdiq.

Vdekja e Titos në moshën e shtyrë (88 vjeçare), njëherësh paraqet fillimin e fundit të Jugosllavisë së AVNOJ-it, të cilën ai e kishte ngritur dhe udhëhequr për afër katër dekada me dorë të fortë, me dinakëri, po edhe me guxim të madh me kursin e vetëqeverisjes socialiste kundër dogmës staliniste, që për t'u shkatërruar do t'i duhen edhe dhjetë vjet përpëlitjesh nga krizat e një pas njëshme e deri te lufta e përgjakshme, që si do të shihet, e gjitha, për pikënisje kishte pikërisht ndryshimet kushtetuese të vitit 1974 dhe raportet e reja në federatë, ku Kosova shfaqej si njësi e barabartë me të tjerat. Ky pozicionim kushtetues, i krijuar në rrethanat politike që i përcaktonte Titoja dhe autoriteti i tij, do të kundërshtohet nga Serbia, po edhe Maqedonia si vasale e saj. Këto njësi federative, pas vdekjes së Titos, barspeshën e re të raporteve në federatë do ta kushtëzojnë me rrënimin e subjektivitet të Kosovës në federatë si dhe kthimin e saj nën tutelën e Serbisë, ku kishte qenë nga viti 1945 deri në vitin 1968.

Në këtë zhvillim, pra dekadën që do të çojë të rrënimi i Jugosllavisë, krahas Serbisë, e cila thaujse nga viti 1976, me "Librin e katër" kishte shfaqur opsionin e saj, Maqedonia paraqiste trampolinën kryesore në këtë proces. Kjo kishte edhe arsytet e veta, ngaqë Shkupi synonte që duke u kthyer Kosovën nën tutelën e



Beogradit, ta defaktorizonte rolin e saj në planin politik. Dhe në tjetrën anë, asaj do t'i mundësonte që me rrënimin e “amzës shqiptare” në Prishtinë, faktorin shqiptar në Maqedoni të lidhur ngushtë me Prishtinën, ta kthente në gjendjen e një pakice kombëtare inferiore, me të drejta të limituara, siç kishte qenë deri në vitet e shtatëdhjeta.

Por, asaj që kishte paraparë “*Libri i kaltër*” dhe përkrahësit e tyre “të hesh-tur” në Maqedoni (Cërvenkovski, Kolishevski, Gligorovi e të tjerë), gjithsesi se u duhej një “shkas” si dhe “pretekstet” (mundësisht të natyrës “separatiste” a të ngjashme me të cilat, në Kosovë para së gjithash, do të sulmohej Titoja dhe trashëgimia e tij),<sup>2000</sup> në mënyrë që të fillojë lufta e përbashkët serbo-maqedonase kundër Kosovës dhe shqiptarëve, pra të fillonte hakmarrja maqedonase ndaj Kosovës dhe shqiptarëve, në emër “të mbrojtjes së Jugosllavisë”!

Dhe, shkasi ideali për këtë u gjende te demonstratat e vitit 1981, që shpërthyen më 11 mars në Prishtinë dhe vazhduan më 26 mars, një dhe dy prill dhe thuajse në vazhdimësi gjatë asaj pranvere “të nxehtë” të Kosovës.

Edhe pse demonstratat e studentëve të Prishtinës u shfaqën “pa adresë” organizative dhe pa bartës,<sup>2001</sup> dhe se në të, ditë më vonë do të inkorporohen grupe dhe organizata të ndryshme, kryesisht marksiste-leniniste, ku krahas kërkesës për Re-

---

<sup>2000</sup> Vllasi, Azem: “*Kosova: fillimi që nuk harrohet*”, Prishtinë, 2017, faqe 264.

<sup>2001</sup> Edhe pse Gjykatat e Prishtinës, gjatë tetorit-dhjetorit 1981, dënuan një numër të konsiderueshëm të demonstrantëve (mbi 150 me burgime nga tre deri në shtatë vjet), si dhe pjesëtarë të disa organizatave (të shumtën marksiste-leniniste), për huthje parullash e të ngjashme, megjithatë, gjykimet nuk nxorën një këshill të përbashkët të demonstratave e as të kërkesave. Madje edhe të ashtuquajturi “grup i studentëve të Universitetit të Prishtinës”, iu atribuua pjesëmarrja në organizim dhe jo koncepti programor. Të kësaj fryme ishin edhe dënimet dhe proceset e shumta që u bënë gjatë vitit 1981, 1982 dhe 1983, të cilat kryesisht lidheshin për pjesëmarrje në demonstrata qoftë edhe në mënyrë të organizuar të apostrofuara “marksiste-leniniste” nga grupe të caktuara me kërkesën për Republikën e Kosovës. Megjithatë, autorë të ndryshëm që merren me problematikën e shkatërrimit të ish Jugosllavisë si dhe shkaktarët e saj të njëmendtë dhe jo me faktorët që u gjenden dhe u përfshinë në këtë proces, (Viktor Meier: “*Wie Jugoslawien verspielt wurde*”, 1995; Pirjevac, Jože: “*Tito i drugovi*”, Zagreb, 2012; Milosavljević, Olivera “*Činjenice i tumačenja. Dva razgovora sa Latinkom Perović*”, Beograd, 2000; Libal, Wolfgang: “*Das ende Jugoslawiens*”, Wien, 1991; Glenny, Misha: “*The fall of Yugoslavia*”, London 1992, e të tjerë), në bazë të indikacioneve, hudhin dyshime në drejtim të Moskës dhe agjenturave të saj në Serbi (të lidhur me politiken unitariste serbe të niveleve më të larta), nga fakti se ato ishin të interesuara, që me ndezjen e konfliktit në Kosovë të arriheshin dy qëllime: të rrëzohej Jugosllavia e Titos (vetëqeverisja socialiste), me çka vendin e saj do t’ia zënte modeli i dogmatizmit sovjetik, si dhe të krijoheshin rrethanat që BRSS-ja, në përputhje me doktrinën e sovranitetit të kufizuar të shpallur nga Brezhnëvi, nga ndonjë thirrje formale që do t’i vinte nga Beogradi, të intervenonte për ta “qetësuar gjendjen” në Jugosllavi. Sipas këtij skenari, BRSS-ja, e cila kishte krijuar “komitet marksiste-leniniste” nëpër shumë qendra jugosllave dhe njërin prej tyre, “*Komitetin e Tivarit*”, të drejtuar prej disa profesorëve universitar e kishte dënuar në vitin 1974 pikërisht pse ata shfaqeshin si “pararobjë staliniste e Moskës”, do të kthente në sferën e saj të interesit Jugosllavinë po edhe Shqipërinë, që në njëfarë mënyre do të përfshihej në konflikt. Kjo do t’ia hapte rrugën rikthimit të Shqipërisë në Paktin e Varshavës si dhe të Jugosllavisë në të. Këto dhe vlerësime të ngjashme, megjithatë mbesin në nivel të supozimeve dhe indikacioneve deri sa të hapen arkivat e shërbimeve informative ushtarake të NATO-s, të CIA-s amerikane, KGB-së sovjetike, KOS-it jugosllav e të tjera.

publikën e Kosovës do të shpërndajnë edhe traktate ideologjike të ngjashme me atë të arsenalit të Tiranës kundër vetëqeverisjes socialiste e të ngjashme,<sup>2002</sup> megjithatë qasja dhe vlerësimi që iu bë atyre me të shpejtë nga organet partiake dhe shtetërore jugosllave në nivelet më të larta, veçmas vlerësimi i tyre si “armiçësore” me karakter kundërrevolucionar,<sup>2003</sup> tregon se demonstratat e Prishtinës nuk ishin vetëm shprehje e “një pakënaqësie studentore me kushtet e ushqimit dhe të banimit”, por ato ishin të organizuara kryesisht për qëllime politike, me të cilat bëhej me dije se Jugosllavia e Titos po merrte fund, me çka në njërën anë shfaqej deponimi i kërkesë së shqiptarëve për Republikën e Kosovës (ose edhe shqiptare në Jugosllavi) si kusht për mbijetimin e saj, dhe në tjetrën anë, shfaqej kursi i Beogradit, fillimisht nën sloganin e “mbrojtjes” së Jugosllavisë, që kushtëzohej me rrënimin e autonomisë së Kosovës dhe kthimin e saj “nën sovranitetin serb”, prej nga thuhej “se ishte shkëputur dhunshëm me ndryshime kushtetuese të vitit 1974”, ku Serbia e forcuar - model për shtetin unitarit-centralist nën dirigjimin e Beogradit.

Autoritet e atëhershme politike dhe shtetërore jugosllave, nën trysinë e Serbisë dhe të Maqedonisë në rolin e një vasali të mirëfilltë të Beogradit, duke përfshirë këtu edhe pjesën “perëndimore” (kroatët dhe sllovenët që kishin interesa të veçanta në këtë zhvillim dhe prisnin përfitimet e tyre), nuk ishin në gjendje të pranonin as faktin e parë, që mbajtja e mëtutjeshme e Jugosllavisë varej, në mos nga ngritja e statusit të saj në atë të Republikës, siç kërkohej nga shqiptarët, atëherë të ruajtjes së pozitës kushtetuese të vitit 1974, e as ta pranonin faktin e dytë, që vinte nga Serbia në formë ultimative - se ruajtja e Jugosllavisë varej nga ndryshimet kushtetuese të cilat kushtëzoheshin me kthimin e Kosovës nën sovranitetin serb.

Ky diskurs, që do të dominojë politikën jugosllave në formën e krizës kronike gjatë tetë viteve të ardhshme, Kosovën dhe çështjen e saj do ta kthejë në një arenë, ku zhvillohej një betejë midis atyre që kërkonin të përfitonin nga ajo për qëllime të tyre (kroatët dhe sllovenët) për të realizuar interesat nacionale deri në

---

<sup>2002</sup> Në informatat e para që shpërndau qeveria jugosllave, Shqipëria shfaqej “inspiruese” e demonstratave. Për këtë u shfrytëzuan parullat e grupeve-marksiste leniniste të njohura nga arsenalit propagandues i Tiranës me përmbajtje staliniste dhe ato kundër vetëqeverisjes jugosllave. Kjo sollti edhe ndërprerjen e menjëhershme të bashkëpunimit kulturor dhe arsimor të Kosovës me Shqipërinë, anipse asnjë burim meritore ndërkombëtar nuk e vërtetoi gishtin e Shqipërisë në demonstratat e Prishtinës. Këtë madje e tha edhe Tirana në komentimin e parë të shfaqur në “*Zerin e Popullit*”, më 9 prill 1981, me ç’rast u përkrahen demonstratat dhe kërkesa e drejtë për Republikën e Kosovës, por u demantua çfarëdo përzjerje e Shqipërisë në këto zhvillime. Madje, Ramiz Alia, pranoi se edhe vetë Shqipëria ishte e befasuar me shpërthimin e demonstratave në Prishtinë. (Shih: Shala, B – Halili, LL dhe Reka, H: “*Unë, Ramiz Alia dëshmoj për historinë*”, Prishtinë, 1992, faqe 89).

<sup>2003</sup> Shih qëndrimet e dy kryesive të Jugosllavisë (shtetërore dhe partiake) në bazë të konkluzioneve të Këshillit Federativ për Mbrojtjen dhe Rregullimin Kushtetues të RSFJ-së më 23 prill 1981, të botuar në “Politika” të Beogradit më, 24 prill 1991.

shkëputje, siç do të ndodhë në të vërtetë në vitin 1991, dhe të tjerëve (serbëve dhe maqedonasve), që kërkonin që me sjelljen ndaj Kosovës (rënimin e autonomisë) ta promovonin modelin e Jugosllavisë unitariste, që edhe në rrethanat e reformimeve eventuale (të daljes prej saj të Kroacisë dhe të Sllovenisë), të shfaqej si Jugosllavi serbe, me çka Beogradi, duke ruajtur formatin e shtetit jugosllav, të mbejtesh fuqi rajonale, për ç'gjë, për t'u ruajtur baraspesha gjeostrategjike dhe ajo gjeopolitike, detyrimisht do të pajtoheshin evropianët, amerikanët dhe sovjetikët (rusët).

Kalkyli i hapur i Beogradit, që për Shkupin ishte i mirëseardhur, duhej të ngrihej mbi vlerësimin, nga të dy kryesitë e Jugosllavisë (ajo shtetërore dhe partiake) si dhe Armata Jugosllave, që demonstratat e Kosovës, mbi platformën e kërkesë për Republikën e Kosovës, të vlerësoheshin si “ngjarje armiqësore”, me “prapavijë kundërrevolucionare”, pikërisht siç ishin vlerësuar ato të vitit 1968 dhe të gjitha zhvillimet tjera që sollën Kushtetutën e vitit 1974, të apostrofuara në “Librin e kaltër” në vitin 1976, gjë që kështu edhe do të ndodhë brenda një kohe shkurtër.

Kualifikimi i parë “*demonstrata armiqësore*”- hapte mundësinë për një hakmarrje an bllok kundër kërkesave të drejta politike të shqiptarëve për ngritjen e statusit të tyre në federatë, me çka përjashtojë mundësia që demonstratat e Prishtinës të shërbenin për çfarëdo shkakut që “ruajtja e Jugosllavisë së Titos” (nga ndonjë sugjerim nga jashtë) të bëhej me vazhdimin e reformave kushtetuese nga viti 1974, ku avancimi i statusit të Kosovës në republikë krijonte rrethana për stabilizimin e saj të mëtutjeshëm.<sup>2004</sup>Ndërsa “*prapavija kundërrevolucionare*” nga

---

<sup>2004</sup> Sipas publicistit të njohur gjerman, Viktor Meier (autor i librit “*Wie Jugoslawien verspielt wude*”), të shprehur në Bon, më 22 nëntor 1995, në një tribunë publike në WDR rreth shkaqeve të krizës së Jugosllavisë, avancimi i statusit të Kosovës në republikë do ta stabilizonte Jugosllavinë, çështje kjo që edhe pritej të ndodhte me rastin e ndryshimeve të ardhshme kushtetuese, për të cilat Kardeli ishte shprehur me rastin e miratimit të tyre në vitin 1974. Por, vdekja e Titos këtë e kishte hequr nga rendi i ditës, edhe pse disa nga liderët e njohur socialdemokratë evropianë (Vili Brant, H. Schmit dhe të tjerë) kreun jugosllav e kishin këshilluar vazhdimisht, që këtë opsion mos t'i ndaheshin, përkundër kundërshtimeve që kishte paralajmëruar udhëheqja serbe e Beogradit në “*Librin e kaltër*”. Sipas Meierit, bashkëpunëtori i Titos, Vladimir Bakariq, gjatë takimeve me liderët e njohur botërorë, haptas kishte shprehur shqetësimin se me vdekjen e Titos po vdiste edhe koncepti i tij për Jugosllavinë federative prej tetë njësie të barabarta, ngaqë “dikush” dhe “nga dika” tashmë kishte skenarin e hapur për ta ndezur Jugosllavinë në Kosovë. Dyshimet për organizimin e demonstratave nga shërbime profesionale nga jashtë Bakariqi e shpreh edhe në Letrën që ia dërgoi Ll. Mojsovit më 29 shtator 1981 me rastin e hartimit të “*Platformës Politike për Kosovën*”, me ç'rast kundërshtoi vlerësimin se prapa tyre qëndrojnë “grupet marksiste-leniniste”, ndonëse ato u shfaqen në demonstrata. “Nuk jam i sigurtë se aty (te grupet marksiste-leniniste v.a) duhet të kërkohet organizatori i demonstratave. Demonstratat janë udhëhequr në mënyrë shumë profesionale që të mund t'i organizojnë grupet e tilla” (Shih letra e V. Bakariqit: AS.1589.teh-eno.1470-Kosovo 1981). Sipas Azem Vllasit, liderit të njohur komunist të linjes “titiste”, që fillimisht përkrahu kursin jugosllav të diferencimeve ideo-politike në Kosovë, por më vonë, do t'i kundërvihet Millosheviqit në fazën kur ai po bëhej gati ta rrenonte autonominë e Kosovës në vitin 1989, për ç'gjë edhe do të burgoset prej tij, ishin pikërisht qarqet e caktura serbe të cilave u konvenonte që menjëherë pas vdekjes së Titos pikërisht në Kosovë të ndodhte diçka antijugosllave dhe kundër Titos. Sipas Vllasit “një gjë e

pozitat “e irredentizmit shqiptar” - mundësonte rrënimin e të arriturave të deritanishme të shqiptarëve në Kosovë, po edhe në Maqedoni dhe viset tjera shqiptare në hapësirën jugosllave, sidomos atyre në planin arsimor dhe kulturor, për ç’gjë Maqedonia ishte si shumë e interesuar, ngaqë ashtu mendonte se mund t’i përjashtonte shqiptarët e atjeshëm që ta ruante karakterin maqedonas të shtetit të krijuar nga Titoja në kuvendin e ASNOM-it në vitin 1944.<sup>2005</sup>

Në këtë aspekt, për Serbinë dhe Maqedoninë me interes të madh, shfaqej, në njërën anë hakmarrja kundër politikanëve shqiptarë të Kosovës, veçmas bashkëpunëtorëve të deridjeshëm të Titos (Fadil Hoxhës dhe Mahmut Bakallit me ndikim gjithnjë e më të madh edhe në politikën jugosllave), që i kishin kontribuar avancimit të pozitës kushtetuese të Kosovës në njësi të barabartë të federatës jugosllave, për ç’gjë ata me të shpejtë ishin anatemuar dhe sulmuar nga të gjitha anët, dhe në tjetrën anë edhe hakmarrja kundër intelektualëve shqiptarë – frymëzues të vetëdijes për barazi dhe emancipim kombëtar mbi të cilën ishte ngritur kërkesa për Republikën e Kosovës në federatën jugosllave. Kjo hakmarrje njëherësh ishte edhe luftë kundër institucioneve kombëtare<sup>2006</sup> (Universitetit të Prishtinës, Akademisë së Shkencave të Kosovës, Institutit të Historisë së Kosovës, Institutit Albanologjik dhe sidomos “Rilindjes” e të tjerave të kësaj vetëdije), që i kishin shërbyer shfaqjes së identitetit shpirtëror të shqiptarëve në Jugosllavi, i lidhur me Prishtinë dhe Kosovën, si qendër e saj.

Politika antishqiptare e Beogradit, së cilës do t’i bashkëngjitet Maqedonia me shumë përkushtim, zhvillohej në dy plane:

-në atë të rrënimin të raporteve të Kosovës me federatën jugosllave, duke e kthyer atë nën tutelën e Serbisë, kryesisht me qëndrime politike të forumeve me të larta partiake dhe shtetërore për karakterin “armiçësor” të kërkesës për Republikën e Kosovës dhe “nga pozitat e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar”, dhe

---

tillë do të ngjallte disponimin antishqiptar edhe në pjesët tjera të Jugosllavisë. Pikërisht këtë e dëshironin qarqet nacionaliste serbe”. (Shih: “Kosova: fillimi që nuk harrohet”, Prishtinë, 2017, faqe 264).

<sup>2005</sup> Ströhm, Karl Gustav: “Ohne Tito, kann Jugoslawien überleben“, Graz, Köln, Wien, 1976.

<sup>2006</sup>Edhe pse përkufizimi “*institucione kombëtare*” për Univerisetin e Prishtinës, Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës si dhe Institutet (atë albanologjik dhe të historisë), nuk ishte në vokabularin administrative e as politik të Kosovës dhe madje anashkalohej përherë me theksimin “institucione arsimore dhe kulturore” të Kosovës që i sherbetin “emancipimit socialist-vetëqeverisës dhe barazisë”, megjithatë, ai do të shfaqet në Platformën Politike për Kosovën të dy Kryesive (të shtetit dhe të Partisë), që do të aprovohet në Plenumin e KQ të LKJ-së në tetor 1981 për të rrënuar bazën kulturore, arsimore të emancipimit politik të Kosovës që çonte te barazia kombëtare në kuadër të federatës jugosllave në përputhje me kushtetuetën e vitit 1974. Ky përkufizimi i sherbeu edhe procesit të diferencimit ideo-politik për rrënimin e strukturës intelektuale, profesionale të institucioneve të Kosovës në të gjitha nivelet shkollore, ato arsimore, kulturore dhe të informimit.

-në atë të veprimit në Maqedoni për rrënimin e pozitës së shqiptarëve në këtë republikë, që po ashtu, me kushtetutën e vitit 1974, si kombësi, bëheshin pjesë e sovranitetit shtetëror.

Kështu, trysnia që i vinte Kosovës nga federata dhe Serbia, i hapte mundësi udhëheqjes politike maqedonase që anatemën e “nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar”, ta shfrytëzonte për një qërim hesapesh me gjithë ato që shqiptarët kishin arritur me mund të madh nga Plenumi i Brionëve i vitit 1966 e këndej në arsimor, kulturë, ekonomi, po edhe përfaqësim politikë në nivel republikan dhe atë federativ.

Në këtë drejtim, konkluzat partiake dhe ato shtetërore të nivelit më të lartë, në të cilat kërkesat e shqiptarëve për barazi që lidheshin me Republikën e Kosovës si dhe identitet kombëtar ishin kualifikuar “armiçësore”, hapnin mundësinë e rehabilitimit të politikës antishqiptare, e cila në Plenumin e Brionëve ishte vlerësuar si “diskriminuese ndaj shqiptarëve”, për ç’gjë, qoftë edhe simbolikisht, edhe ishin marrë masa partiake dhe ligjore ndaj shkaktarëve të tyre. Në rrethanat e reja, me aministrin e forumeve më të larta shtetërore si dhe kualifikimet e dala prej tyre, politika antishqiptare, rikthehej në një formë edhe më të ashpër. Andaj, nuk ishte e rastit që në Maqedoni, gjithnjë “në kërkim të bartësve të veprimtarisë armiçësore”, në shënjestër të ndjekjeve politike dhe penal u gjenden shumë nga ata që në vitet pesëdhjeta dhe të gjashtëdhjeta kishin kaluar nëpër burgje nën akuzën e “nacionalizmit shqiptar” ose “të formimit të grupeve armiçësore që kërkonin bashkimin me Kosovën”, por edhe ndonjë që lidhej me NDSH-në dhe programin e saj për bashkim kombëtar, të manifestuar në Shkup në vitin 1945, e përhapur edhe në Kosovë, për ç’gjë në proceset e viteve 1945, 1946 dhe 1947 qenë burgosur dhe dënuar me burgime të gjata po edhe me pushkatim shumë nga intelektualët shqiptarë që i kishin takuar kësaj organizate.<sup>2007</sup>

Nën anatemën “se nacionalizmi dhe irredentizmi shqiptar ishte si uji që s’flenë”, hakmarrja maqedonase kundër shqiptarëve, shfaqej si një “gjendje e natyrshme represive” e përhershme madje, që duhej të shtrihej dhe të prekte të gjitha sferat jetësore dhe strukturat shoqërore (arsimin, kulturën, ekonominë dhe të tjerat), në mënyrë që t’i ndalet rrjedha. Kështu, krahas arsimtarëve të cilët ngarkoheshin më së shumti “me mëkatet e irredentizmit shqiptar”, në shënjestër të represionit duhej të gjendeshin studentët dhe të rinjtë që kishin studiuar në

---

<sup>2007</sup> Krahas NDSH-së, e themeluar në Shkup në vitin 1945 e që kishte në program bashkimin demokratik shqiptar, përhapja e së cilës u shtri edhe në Kosovë dhe veprimtaria e së cilës vazhdoi deri në vitin 1947, kur udhëheqësit e saj u burgosën dhe u dënuan me burgje të rënda, ndërsa gjasht prej tyre me pushkatim, në vitin 1958, në Maqedoni u riaktivizua një parti e ngjashme, e cila kërkonte bashkimin e viseve shqiptare të Maqedonisë me ato të Kosovës.

Kosovë dhe ishin kthyer në pjesë të identitetit të përbashkët shqiptar, paçka se me këtë, nga viti 1969 e deri në 1981, edhe politika maqedonase ishte pajtuar.

Kësaj politike represive, të operacionalizuar në përputhje me veprimet e Beogradit në nivel federativ dhe ato të Serbisë në Kosovë, ku ajo me dekrete politike dhe jashtëligjshëm - në formën e një puçi të “heshtur” -kishte rikthyer praninë e vet në Kosovë dhe vendoste për të gjitha, në federatë, do t’i prijnë përfaqësuesit e Maqedonisë: Llazar Kolishevski –anëtari i Kryesisë së RSFJ-së, Llazar Mojsov - kryetar i kryesisë së KQ të LKJ-së, Stojan Andov – nënkryetar i Kuvendit të Jugosllavisë, e ndonjë tjetër, të cilëve do t’u vinë në ndihmë edhe Krste Cërvenkovski e KiroGligorovi - aktivë në thuajse të gjitha komisionet e ngritura që merreshin me problematikën e Kosovës.

Natyrisht se Llazar Kolishevski, një kuadër i hershëm maqedonas i kalitur në Serbi nga paralufta e këndej, përherë i gatshëm të mbetj nën sjetullën e Beogradit, u vunë krye të veprimeve rrënuese kundër shqiptarëve në Jugosllavi.Si anëtarët i Kryesisë së RFSJ-së dhe njëherësh anëtarë i Këshillit Federativ për Mbrojtjen e Rregullit Kushtetues, i dha mbështetje formale fushatës antikushtetuese me të cilat Kosovës një nga një iu morën shumë nga kompetencat që ia siguronte Kushtetuta e vitit 1974. Vendimtare ishte mbledhja e 23 prillit 1981 në të cilën Këshilli, në mënyrë jokushtetuese, aprovoi “pakon e masave për mbrojtjen kushtetuese të vendit”. Ato u aprovuan në mbledhjen e Kryesisë së KQ të LKJ-së të 29 prillit, ku edhe morën dritën jeshile, ndonëse disa prej tyre ishin futur në përdorim edhe pa këto vendime të nesërmen e shpërthimit të demonstratave.

Si qëndrime antikushtetuese, që i miratoi Kryesia e KQ të LKJ-së, pasi që të kishte filluar zbatimi i tyre,ishin urdhri për futjen e përdorimin e njërive policore federative në Kosovë, të cilat suprimonin komandon e Shërbimit Policor të Kosovës, si dhe vendimi që njësitë e APJ-së në Kosovë, të cilat ishin dërguar atje pa u shpallur zyrtarisht vendosja e gjendjes së jashtëzakonshme nga Kryesia e RSFJ-së, me të cilat “heshtazi” Kosova ishte vu nën një regjim ushtarak, të ngjashëm me atë të vitit 1945.

Me këtë veprim puçist, jo vetëm që ishte suprimuar Mbrojtja Territoriale e Kosovës, me ç’rast strukturat e saj (njësitë rezerviste prej 50 mijë vetash), ishin vu nën komandën e APJ-së, por edhe jeta e gjithëmbarshme politike dhe institucionalei ishte nënshtruar trysnisë së pranisë ushtarake.

Një vendim tjetër rrënues, që doli nga këto konkluzat për të cilat u angazhua me shumë përkushtim Kolishevski, kishte të bënte me rishqyrtimin (ndërprerjen e njëanshme) të marrëdhënieve të RSFJ-së me Shqipërinë. Ky forum doli me ven-

dimin për tërheqjen e mikpritjes ambasadorit shqiptar në RSFJ, me argumentin “e përzjerjes së tij në punët e brendshme”. Po ashtu, u kërkua ndalimi i tërësishtëm i angazhimit të mëtejshëm të profesorëve nga Shqipëria për zhvillimin e ligjëratave në Universitetin e Prishtinës dhe në shkollat tjera. Me këtë rast u kërkua ndalimi i shfrytëzimit të literaturës nga Shqipëria si dhe ndërprerja e menjëhershme e shkëmbimeve kulturore me Shqipërinë.<sup>2008</sup>

Tandemi Kolishevski-Mojsov në kreun shtetëror dhe partiak jugosllav, ua përcaktoi dinamikën këtyre veprimeve, që ato të dukeshin si veprime të kreut jugosllav, ndonëse dihej se prapa tyre ishte faktori politik serb dhe ai ushtarak që tashmë ishte vu në shërbim të tij dhe në Kosovë po e jetësonte puçin kundër Jugosllavisë. Meqë partia ishte forca kryesore politike e vendit që drejtonte proceset kryesore, ishte e pritshme që L Lazar Mojsovi, në cilësinë e Kryetarit të Kryesisë së KQ të LKJ-së, të kërkojë formimin e një komisioni të përbashkët të KK të LK të Kosovës, dhe KQ të LK të Serbisë, me detyrën që ta “konstatojë përgjegjësinë partiake të Mahmut Bakallit”.

Kështu, komisioni partiak që e drejtonte Mojsovi, krahas paralajmërimit se LKJ-nuk ishte më parti në përputhje me frymën që ia kishte përcaktuar Titoja, por një grusht i ri ideologjik në duart e unitaristëve të Beogradit, në të vërtetë paraqiste edhe fillimin e hakmarrjes serbe dhe maqedonase kundër Mahmut Bakallit, si bashkëpunëtorë dhe i besueshëm i Titos në vitet vendimtare të reformave politike dhe shoqërore të Jugosllavisë, i cili, i kishte lënë pas thuajse të gjithë të tjerët. Dhe, po ashtu, paraqiste hakmarrje ndaj LK të Kosovës, e cila prej vitësh me organizatën e Serbisë komunikonte në nivelin e partnerit të barabartë në kryesinë e KQ të LKJ-së, duke ia dalë që linja partiake e komunistëve të Kosovës, e dominuar nga shqiptarët, të kthehet në një pragmatizëm politik në shërbim të avancimit të pozitës së Kosovës në nivel të federatës jugosllave, por edhe të krijimit të një vetëdije të barazisë institucionale nëpërmes institucioneve kulturore dhe arsimore, siç ishin Universiteti i Prishtinës, Akademia e Shkencave të Kosovës, “Rilindja”, RTV i Kosovës e të tjera.

Dënimi i Bakallit hapte rrugë që partia të “pastrohej” nga brenda për t’ia lëshuar vendin “kuadrove lojale me vetëdije të patriotizmit jugosllavë” (në të vërtetë kuadro të Serbisë), shumë prej të cilëve, thuhej se ishin mënjanuar “nga Bakalli dhe klika gjakovare” për vite të tëra.<sup>2009</sup> Me këtë veprim krijoheshin rretha-

---

<sup>2008</sup> “Politika”, Beograd, më 24 prill 1981

<sup>2009</sup> “Klika gjakovare” – ishte një “anatemë” përçarëse midis shqiptarëve, e lansuar në Kosovë nga qarqet e caktuara serbe të Beogradit mbas Plenumit të Brionëve të vitit 1966, për gjoja “rolin e udhëheqësve kryesorë

nat e përshtatshme për largimin dhe eliminimin e intelektualëve “irredentistë” dhe “nacionalistë”, që “kishin pushtuar” institucionet kryesore të arsimit dhe të kulturës (Universitetin, mediat, shtëpitë botuese e të tera).

Komisioni për përgjegjësinë partiake të M. Bakallit, ndonëse “i përbashkët” midis KK të LK të Kosovës dhe KQ të LK të Serbisë, në përputhje me raportin e ri të forcave që Beogradi kishte filluar ta vendoste me forcë, ishte më tepër një hetim thuajse policor dhe pak apo aspak “partiak”, siç thuhej, me të cilin, qërimi i hesapeve me Bakallin paraqiste qërim të drejtpërdrejtë të hesapeve me kursin e Titos për ngritjen e pozitës së Kosovës në federatën jugosllave si njësi e barabartë dhe nxjerrjen e saj nga ndikimi i Beogradit, ku kishte qenë nga viti 1945 e këndej, ndonëse kreu partiak jugosllav me hipokrizi ruante sloganin: “Pas Titos - Tito”.

Komisioni hetimor, që punoi gjatë qershorit, “në kërkim të zbardhjes së fakteve që lidhen me përgjegjësinë personale të Mahmut Bakallit për gjendjen politike në Lidhjen e Komunistëve të Kosovës, si thuhej, për gabimet dhe lëshimet që kanë sjellë deri te shpërthimi i nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptaro-madh dhe demonstratat kundërrevolucionare në Krahinë”,<sup>2010</sup> me ato që doli, me ç’rast Bakalli u “fajësua” me “njërin ndër gabimet më të pafalshme të tij që si Kryetar i Komitetit Krahinor nuk ka insistuar me këmbëngulësi në ndërtimin dhe zbatimin e një platforme të fuqishme ideo-politike në luftë kundër nacionalizmit”, dhe se “lëshimet u mundësuan nga sjelljet e tij liberale dhe të luhatshme ndaj manifestimeve të dukshme të nacionalizmit dhe të irredentizmit shqiptar”, me çka “duke iu shmangur luftës ku ndër nacionalizmit, duke nënçmuar seriozitetin e

---

kosovarë me origjinë nga Gjakova” (F. Hoxhës, Xh. Nimanit dhe vëllezërve të tij, Y. Pulës, V. Devës, Xh. Hamzës, M. Bakallit, P. Nushit e të tjerëve) ekonomikisht për ta “stimuluar Gjakovën dhe qytetet përreth” në dëm të “katundeve” dhe “katundarisë”. Kjo anatomë, fitoi “platformën” e vet në fejttonin “*E vërteta për Kosovën*”, të dr. Halit Tërnavcit, profesor në Universitetin e Beogradit, të botuar në disa vazhdimë në “*Politika*” të Beogradit, me ç’rast, në shënjestër ishte F. Hoxha, Bakalli dhe gjithë ata që “kishin përçarë Kosovën mbi bazuat qytet-katund”! Prof. H. Tërnavci, akuzonte me të madhe F. Hoxhën, Bakallin dhe të tjerët nga “klika gjakovare” pse kishin sjellë “nipër dhe akraba në krye të institucioneve arsimore dhe kulturore”. Këtu përmendej, rektori Gazmend Zajmi (nip i Xh. Nimanit), pastaj akademik Ali Hadri, që për Tërnavcin ishte “frymëzuesi kryesor i nacionalizmit shqiptar” ( sipas tij akraba i F. Hoxhës, edhe pse kjo nuk ishte e vërtetë dhe as që ishte gjakovar, por pejanë) e shumë e shumë të tjerë. Nuk vonoi dhe ata u shkarkuan nga postet që mbanin, duke iu nënshtuar diferencimit ideo-politik po edhe kërcënimeve për ndjekje penale. “Platforma” e Halit Tërnavcit, u shërbeu disa karrieristëve të ngjashëm në Kosovë, veçmas atyre që “klika gjakovare” i kishte mënjeluar ose larguar nga udhëheqja e Kosovës nga viti 1996-1981 duke i “pasivizuar” në federatë pikërisht pse kishin penguar avancimin e pozitës së Kosovës në federatë (A. Shukriu, S. Hasani, K. Shiroka e të tjerë), të cilët, me të shpejtë, u riaktivizuan në shërbim të Beogradit në procesin e gjatë të diferencimit ideo-politik në Kosovë, që si “lojalë” të Beogradit, morën stafetën edhe për rrënimin e autonomisë së Kosovës më 23 mars 1989.

<sup>2010</sup> Shih: Arhiv Slovenije, 1589. Teh. Eno.1479. Kosovo 1981 g. “*Izveštaj Komisije Predsedništva CK SKS i PK Kosovo za utvrđivasnje partiske odgovornosti Mahumta Bakalija*”, te Lita, Qerim: “*Çështja shqiptare në RSFJ 1981-1990*”, Shkup, 2014, faqe 69.



paraqitjes së nacionalizmit, duke ikur që për ato paraqitje t'i njoftojë organet e LKS e LKJ-së, ai në masë të madhe ka ndikuar në përhapjen e tyre”,<sup>2011</sup> vërtetoi fund e krye atë se në Kosovë tashmë, praktikisht, kishte filluar lufta për rrënimin e modelit të Jugosllavisë së Titos të filluar në vitin 1966 dhe të vendosur në vitin 1974, paçka se e gjitha bëhej gjoja në emër të mbrojtjes së saj.

Propozimi i Komisionit që M. Bakalli të përjashtohet nga Komitetit Krahi-nor i LK të Kosovës, por që ai të mbetej në parti me vërejtjen e fundit me arsyeti-min “se duhet t'i ofrohet shans që me sjelljet dhe punën e tij në periudhën e ardhshme të përmbush qëndrimin kritik dhe vetëkritik” ishte modeli i një partie nën ndikimin e plotë të unitaristëve dhe nacionalistëve të Beogradit për ridefini-min e Jugosllavisë në një shtet sipas formatit serb dhe assesi ndryshe.

Natyrisht se për Beogradin dhe ata që qëndronin prapa “Librit të Kaltër”, kjo luftë duhej të fillonte në Kosovë dhe të vazhdonte tutje në nivelet federative. Arsenali i saj (lufta kundër intelektualëve “irredentistë” si dhe “hapësirës së tyre” - institucioneve, shkollave, medimeve e të tjera), ishte paraparë si fushatë e për-hershme shkallmuese me anën e procesit të diferencimit ideo-politik që do të dalë nga “*Platforma politike e LKJ-së në zhvillimin e vetëqeverisjes socialiste, vëlla-zërim bashkimit dhe bashkëjetesës në Kosovë*”.<sup>2012</sup>

## RIKTHIMI I HAKMARRJES NDAJ SHQIPTARËVE

Reagimet e shtetit jugosllav pas shpërthimit të demonstratave të marsit dhe të prillit në Prishtinë dhe pjesët tjera të Kosovës hapen kapitullin e ri të poli-tikës antishqiptare në nivel të Jugosllavisë. Kualifikimet e rënda të demonstra-tave “si armiçësore” nga “pozitat e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar”, si dhe masat që u morën nga Kryesia e Jugosllavisë (vendosja e gjendjes së jashtë-zakonshme në Prishtinë, pastaj vendosja e gjendjes së krizës në Kosovë si dhe

---

<sup>2011</sup> Po aty, faqe 70.

<sup>2012</sup> “*Platforma për Kosovën*” u aprovua në Mbledhjen XX të KQ të LKJ-së më 17 nëntor 1981, prej nga doli edhe i ashtuquajtur “*Program aksional për diferencimin ideo-politik*”, që për vitet të tëra Kosovën e vuri nën tryshninë e diferencimeve nga “pozitat e nacionalizmit dhe të irredentizmit shqiptar”, një kartë bian-ko, për eliminimin si dhe largimin e intelektualëve shqiptarë nga arsimit, kultura po edhe institucionet dhe ndërmarrjet drejtuese, pastaj administrata shtetërore, sidomos nga gjyqësori, policia dhe armata. Programi aksional njëherësh u kthye në një inkuizitor të vlerave kulturore dhe arsimore shqiptare, të anatemuara “si frymëzuese të irredentizmit shqiptar”, me ç’rast filloi fushata “për pastrimin” e librave shkollorë, plan-programeve, veprimtarisë botuese, teatrove si dhe shoqërive kulturore nga “përmbajtjet nacionaliste” si dhe largimi i autorëve “nacionalistë” nga jeta krijuese.

procesi afatgjatë i diferencimit ideo-politik), ua krijuan infrastrukturën politike dhe atë “ligjore” këtyre veprimeve, të cilat u përcollën me represalie të shumta nga burgimet, bisedat informative, përjashtimin nga puna dhe veprimet tjera, që morën formën e një fushate të hapur kundër një popullate që thuajse ishte nxjerrë nga ligji.

Por, lufta e ashpër që filloi në Kosovë, me të shpejt u përhap edhe në viset tjera shqiptare, në Maqedoni, në Luginë të Preshevës dhe në Mal të Zi. Masat që merreshin gjatë proceseve të pandalshme të diferencimeve ideo-politike, në të vërtetë, ktheheshin në ndjekje penale të vazhdueshme, të cilave, të shumtën ua përcaktonte dinamikën dhe përmasat shtypi i Beogradit, ku fjalën kryesore e kishte “Politika” e Beogradit me pamfletin bulevardesk (Politika ekspres). Ndaj, nuk është aspak e habitshme, që nga viti 1981-1989, nëpër organet policore dhe ato hetimore, në forma të ndryshme, u trajtuan rreth 350 mijë qytetarë shqiptarë, me ç’rast, për kundërvajtje u dënuan 11 mijë persona, ndërsa penalisht nën akuzën për veprimtari armiqësore dhe bashkim kundërrevolucionar në organizata armiqësore, u dënuan 4600 veta.<sup>2013</sup>

Në Maqedoni, vrulli antishqiptar vinte nga bashkëveprimi me politikën unitariste të Beogradit në kursin kundër Jugosllavisë së Titos, e cila kërkonte që sa më shpejtë të rrëronte identitetin kushtetues dhe institucional të Kosovës e me këtë edhe çdo gjë shqiptare në të që zhvillohej nën “ombrellën” e “rikthimit të bashkëjetesës” dhe “të vëllazërim-bashkimit” të dala nga platforma partiake dhe vendimet tjera antikushtetuese të Kryesisë së Jugosllavisë dhe organeve të tjera federative (Kuvendi Federativ dhe Këshilli Ekzekutiv Federativ). Dhe, vinte edhe nga vetë kursi i njohur antishqiptar i fillimviteve të pesëdhjeta e deri në gjysmën e të gjashtëdhjetave, kur pas Plenumit të Brioneve edhe Maqedonia detyrohet të heq dorë nga diskriminimi i shqiptarëve dhe këtë ta ndryshojë dukshëm me përmirësimin e gjendjes së tyre në planin shoqëror, politik dhe sidomos atë arsimor e kulturor, që u pasqyrua me hapjen shkollave të mesme në gjuhën shqipe, zgjerimin e veprimtarisë informative dhe asaj botuese në gjuhën shqipe, me ç’rast bashkëpunimi arsimor dhe kulturor me Kosovën luajti një rol të rëndësishëm në ngritjen e vetëdijes së shqiptarëve në përmasa jugosllave.

Masat e para antishqiptare në Maqedoni filluan pas sjelljes së “*Platformës politike për Kosovën*” nga ana e KQ të LKJ-së në tetor të vitit 1981, ndonëse ky dokument antipartiak nuk e pati as miratimin e plotë në forumet e larta partiake

---

<sup>2013</sup> Më gjerësisht rreth represionit shtetëror në Kosovë gjatë viteve 1981-1989 shih Zülch, Tilan: “*Etničko čišćenje , Genocid za Veliku Srbiju*”, Sarajevo 1996, faqe 157-176.

dhe u kundërshtua madje edhe nga bashkëpunëtori i parë i Titos, V. Bakariq, çështje kjo që mbeti e heshtur qëllimisht.<sup>2014</sup>

Pavarësisht kësaj, fushatës antishqiptare të Beogradit, shtysën kryesore do t'ia japin liderët maqedonas në federatë L. Kulishevski, L. Mojsov, S. Andov e të tjerë, që praktikisht u kthyen në zëdhënës të politikës unitariste serbe në raport me Kosovën po edhe me pjesët tjera të Jugosllavisë (Slloveninë dhe Kroacinë), për ç'gjë ata mendonin se ishte koha e duhur dhe rrethanat e duhura.

Shikuar nga këndvështrimi historik i shfaqjes së shtetit maqedonas në kuadër të federatës jugosllave dhe pretendimeve të vazhdueshme që shqiptarëve t'u mohohet etnia historike me rrënjë në antikitet si dhe identiteti shpirtëror dhe ai kombëtar, bie në sy fenomeni i riciklimit të hakmarrjeve pas gjendjeve afatshkurta të “normaliteteve”, kur shqiptarët në rrethanat e realiteteve pushtuese sllavo-komuniste, përpiqeshin sado pak ta merrnin veten. E tillë ishte hakmarrja e viteve 1944-1945 “kundër kuislingëve dhe antikomunistëve” e drejtuar kundër rezistencës kombëtare me një çmim të lartë gjaku për ç'gjë u përdoren bashkarisht partizanët jugosllavë, bullgarë dhe shqiptarë. E dyta shfaqet në vitet 1949-1966 - pas prishjes së marrëdhënieve ideologjike midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë me shpërnguljen për në Turqi dhe të tjerat. Ndërsa e treta paraqitet nga viti 1981-1991, me të cilën synohej defaktorizimi përfundimtar i shqiptarëve në procesin e shtetndërtimit të Maqedonisë, që erdhi pas shpërbërjes së Jugosllavisë.

Nëse mund të thuhet se gjatë hakmarrjes së parë maqedonasit kishin aleatë shtetin komunist jugosllav dhe atë komunist të Shqipërisë dhe vepronin bashkarisht, ndërsa gjatë hakmarrjes së dytë nuk e kishin Shqipërinë e E. Hoxhës, por kishin unitarizmin jugosllav që dirigjohej nga Beogradi, gjatë hakmarrjes së fun-

---

<sup>2014</sup> Vladimir Bakariq, bashkëpunëtor i ngushtë i Titos nga ditët e para kur edhe u krijua koncepti i Jugosllavisë së AVNOJ-it në vitin 1943, kundërshtoi “Platformën Politike për Kosovën”. Në një letër të hapur dërguar L Lazar Mojsovit, më 29 shtator 1981, Bakariq kritikon hartuesit e Platformës thuajse në të gjitha pikat e saj kryesore, duke e nxjerrë atë si një dokument “të papërshtatshëm dhe madje të dëmshëm”, ngaqë jo vetëm që nuk përcakton shkaqet dhe faktorët që sollën deri të demonstratave e Prishtinës, por ato i adreson gabimisht, pikërisht të politika e LKJ-së për barazinë, me çka fitohet bindja se “barazia e tepërt shqiptarët i paska kthyer në kursin irredentist dhe armiqësor”! Andaj, sipas Bakariqit, “mjekimi për Kosovën nuk është që të zvogëlohet numri i studentëve e ngjashëm, që është e pamundur, por ndaj kthimit të besimit të tyre ndaj Jugosllavisë në territorin e saj nëpërmes zbatimit të vetëqeverisjes në mënyrë konsekuente e themelore”. Në këtë aspekt, Bakariqi, në pikën 3, është edhe më i drejtpërdrejt kur thotë “se shumica e vlerësojnë se dhënia e më shumë të drejtave se sa u takojnë sipas Kushtetutës nxiti nacionalizmin dhe këto incidente. Kjo nuk është njëllloj. Nëse ai qëndrim krijoi nacionalizëm, atëherë çështja kryesore është që me masa të duhura ligjore gjendja të kthehen në kornizën kushtetuese. Nëse është e kundërta, atëherë duhet të shtrohet pyetja kryesore rreth sigurimit të të drejtave nacionale dhe të të drejtave të kombësive, ajo që na duhet”. (Letra në tërësi te Lita, Qerim: “Çështja shqiptare në RSFJ 1818-1990”, Shkup, 2014, faqe 203-205).

dit, ata praktikisht u vunë në rolin e vasalëve të Serbisë kundër Kosovës dhe kundër shqiptarëve në përgjithësi, e me këtë, u vunë edhe në shërbim të rrënimit të Jugosllavisë së Titos, pikërisht asaj që në Kuvendin e ASNOM-it të gushtit 1944 i kishte krijuar shtet nga vendimet politike.

E përbashkët midis hakmarrjes së parë dhe kësaj të fundit, shfaqej komponenti “veprimtari armiqësore nga pozitat e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar”, sfondi i së cilës mbështetej mbi “kundërrevolucionin” dhe “kundërrevolucionarët”, paçka se e para lidhej me idetë “shqiptaro-mëdha” siç quheshin ato që përfaqësonte NDSH-ja dhe nacionalistët shqiptarë që kundërshtonin rripushtimin sllavo-komunist, ndërsa “kundërrevolucionarët” e rinj, lidheshin me kërkesën për Republikën e Kosovës në kuadër të federatës jugosllave, që anatemohesh si “armiqësore”, edhe pse ajo mbështetej mbi të drejtën demokratike dhe barazinë si e drejtë civilizuese.

Në këtë aspekt, politikanët maqedonas lojalë ndaj Beogradit, ndjeheshin edhe më të motivuar kundër kërkesës për republikën e Kosovës si dhe vetëdijes për barazi që tashmë ishte krijuar te shqiptarët në Maqedoni dhe gjetiu, ngaqë vlerësoninse rrënimi i saj ndalonte opsionet eventuale për bashkimin e shqiptarëve në një republikë të përbashkët jugosllave, që do të mund të shfaqej në përputhje me skenarët e ndryshëm të faktorit ndërkombëtar po qe se shteti i përbashkët jugosllav do të futet në ndonjë krizë prej nga nuk mund të dalë e të ngjashme, skenar ky që për kosto do të mund të kishte pikërisht shuarjen e Maqedonisë nga harta shtetërore, në të cilën edhe ashtu ishte shfaqur si konstrukt politik i Titos në kuadër të Jugosllavisë federative të AVNOJ-it.

Ndaj, nëse politika antishqiptare e Beogradit ushqehej vazhdimisht nga konceptet hegjemoniste të “së drejtës së sajuar” historike, ku Kosova shfaqej “djep mesjetar serb”, për ç’gjë, sipas Memorandumit të fundit të Akademikëve serbë, ajo duhej t’ia ruante platformën Jugosllavisë (serbe), që do ta zëvendësonte atë të Titos,<sup>2015</sup> politika maqedonase e Shkupit, mbështetej nga frika se Republika e Kosovës mund ta shuante shtetin maqedonas të Titos.

Ky “dallim”, në të vërtetë, shfaqej si emërues i përbashkët, që motivonte në njërën anë ndjenjën e “rizgjimit serb”, që të shfrytëzohej “çasti i volitshëm i historisë”,<sup>2016</sup> siç ishte ai pas vdekjes së Titos në vitin 1980 dhe demonstratat e Kosovës të vitit 1981, dhe “ndjenjën e frikës maqedonase” deri në fobi nga “ri-

---

<sup>2015</sup> “Memorandumi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë” 1986, “Delo”, Lubjanë, 1986.

<sup>2016</sup> “Ćosić, Dobrica: „Stvarno i moguće“, Budva, 1987.

lindja shqiptare” me qendër Kosovën,<sup>2017</sup> që duhej penguar me çdo kusht dhe me të gjitha mjetet, sidomos me qëndrimet politike, që u shfaqen në vitin 1981, në “emër të mbrojtjes” së Jugosllavisë nga “nacionalizmi dhe irredentizmi shqiptar”, që i sanksiononte “Platforma politike për Kosovën”, nga ana e KQ të LKJ në tetor të vitit 1981, të kthyer në programe operative.

Kështu, fushata historike antishqiptare në Maqedoni filloi menjëherë pas aprovimit të “Platformës politike për Kosovën” dhe si e tillë mbeti e hapur deri me shkatërrimin e Jugosllavisë. Në periudhën dhjetëvjeçare e gjithë vëmendja u përqendrua te rrënim i arsimit shqiptar në Maqedoni, me ç’rast në shënjestër të organeve partiake (diferencimit të vazhdueshëm ideo-politik në arsim), por edhe të atyre administrative-policore u gjenden mësimdhënësit shqiptarë.<sup>2018</sup>

Ato u përcollën edhe me masat tjera kundër arsimit shqip: riemërtimi i shkollave shqipe të cilat mbanin emra të figurave kombëtare shqiptare; tërheqjen nga përdorimi i mijëra librave dhe publikimeve në gjuhën shqipe,<sup>2019</sup> ndërrimi i plan programit mësimor për shkollat fillore dhe të mesme në gjuhën shqipe në lëndët e historisë, gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe muzikës; mbyllja e paraleleve në gjuhën shqipe nëpër shkollat e mesme profesionale si dhe mbyllja e paraleleve të gjimnazeve<sup>2020</sup> dhe në fund të tyre hapja e të ashtuquajturave “paralele të përziera”, ku mësimi zhvillohej në gjuhën maqedonase.<sup>2021</sup>

Kapitull i veçantë në fushatën e Shkupit kundër arsimit dhe kulturës shqiptare paraqitej çështja e pengimit dhe zvogëlimit të numrit të studentëve shqiptarë në Maqedoni dhe të ndërprerjes së regjistrimit të tyre në Universitetin e Prishtinës, i vlerësuar tashmë “qendër e irredentizmit dhe nacionalizmit shqiptar”.<sup>2022</sup>

---

<sup>2017</sup>Ströhm, Karl Gustav: „Ohne Tito, kann Jugoslawien überleben?“, Bastei-Lübbek, Styua, Graz, Wien, Köln 1976; Meier, Viktor: „Wie Jugoslawien verspielt wurde“, 1995.

<sup>2018</sup> Në vitin shkollor 1981-1982 u morën masa ideo-politike ndaj 320 arsimtarëve shqiptarë, me ç’rast 150 u larguan nga puna. (ДАРМ.1.427.525.17-249-272: Информациа со оценки за активностите и презентени мерке во СКМ за спроведување на заклучоците од 9-та седница на ЦК СКЈ, te Lita, Qerim: „Çështja shqiptare në RSFJ 1981-1990“, Shkup, 2014, faqe 110).

<sup>2019</sup> Në vitin 1981 u terhoqen nga përdorimi 5.550 libra shqipe me anatemën “e papërshtatshëmërisë ideo-politike”. Po aty, faqe 111.

<sup>2020</sup> Mbyllja e paraleleve në gjuhën shqipe në shkollat e mesme profesionale u bë në vitin 1987/88.

<sup>2021</sup> Mbyllja e gjimnazeve në gjuhën shqipe dhe zëvendësimi i tyre me “paralelet e përziera” në gjuhën maqedonase u përcoll edhe me largimin e arsimtarëve shqiptarë si dhe dënimin e një pjese të tyre për “veprimtari armiqësorë” (ДАРМ.1.427.528.31-329-333).

<sup>2022</sup> Në “Platformën politike për Kosovën” të KQ të LKJ-së, të tetorit 1981, Universiteti i Prishtinës fokusohet ndër shkaktaret kryesor të “irredentizmit dhe nacionalizmit shqiptar”, ku jo rastësisht kishin shpërthyer demonstratat, më 11 mars. Me këtë rast, diferencimi ideopolitik deri te sjellja para përgjegjësisë ligjore duhet për përfshijë jo vetëm profesorët shqiptarë që kishin sjellë indoktrinimin, por edhe studentët që ishin përfshirë në organizimin e veprimtarive “armiqësore”. Të tillëve duhet t’u merret e drejta e studimit. NË

Kjo u pasqyruar në vitin e ardhshëm akademik (1981/82) kur u përgjysmua numri i studentëve shqiptarë në Akademinë Pedagogjike dhe Fakultetin Filologjik në Shkup nga 2.365 në 1300.<sup>2023</sup>

Trendët e zvogëlimit të studentëve shqiptarë në Universitetin e Shkupit vazhduan edhe në vitet në vijim. Ndikim të madh këtu pat edhe “kriteri moralopolitik” gjatë regjistrimit, kriter ky që kalonte nëpër dosjet partiake dhe policore.

Pos në Shkup, numri i studentëve shqiptarë, u zvogëlua dukshëm në Universitetin e Prishtinës. Në vitin akademik 1982/83, numri i studentëve shqiptarë nga Maqedonia, nga 1100 sa ishte në vit (në përputhje me kotat e përcaktuara për studentët shqiptarë nga Maqedonia), ra në 220 për t’u zvogëluar nga viti në vit. Kjo ndodhi edhe nga shkakut se Universiteti i Prishtinës, nën trysinë e masave politike, u detyrua që ta zvogëlojë dukshëm kuotën për studentët shqiptarë nga Maqedonia dhe viset tjera nga 1500 në vit në gjithsej në 300.<sup>2024</sup>

Krahas arsimit dhe kulturës si dhe diskriminimit në punësim, administratë shtetërore dhe në ekonomi, represioni shtetëror kundër shqiptarëve në Maqedoni, përfshiu edhe fushat tjera të jetës shoqërore, me të cilat atyre u prekej por edhe mohohesh edhe karakteri i shprehjes demografike të etnisë së tyre. Kjo u pasqyrua me ligjin për emërtimin e toponimeve si dhe përdorimin e tyre zyrtar vetëm në versionin sllav. Me këtë rast *Shkupi* duhej të shkruhej “Skopje”, *Dibra* – “Debar”, *Manastiri* – “Bitolla” e kështu me radhë. Në këtë mënyrë, shqiptarët gjatë shkrimit, duhej t’i përdornin vetëm emërtimet sllave të toponimeve dhe të vendbanimeve. Këto vendime përfshinin edhe dokumentet zyrtare dhe ato administrative të gjitha niveleve, nga letërnjoftimet si dhe dokumentet tjera (pasaportë), ku vendbanimet e tyre shkruhehin vetëm në versionin sllav. Madje, versioni sllav i toponimeve dhe vendbanimeve iu imponua Radio Televizionit të Maqedonisë dhe Radio Maqedonisë, me ç’rast folësit e programit emërtimin Shkup duhej ta lexonin “Skopje”, Manastirin “Bitolla” dhe kështu për të gjitha të tjerat.<sup>2025</sup>

Varianti maqedonas i toponimeve dhe emrave, si formë e papresedan e kulturociditetit në rrethanat e reja, duhej të përfshinte dhe tekstet shkollore në

---

Maqedoni, qëndrimet e Platformës politike u interpretuan si qëndrime për rishqyrtimin e bashkëpunimit midis Universitetit të Prishtinës dhe atij të Shkupit, zvogëlimin apo edhe ndërprerjen e regjistrimit të studentëve nga Maqedonia në Prishtinë, e mbi të gjitha, ato u kthyen “në direktiva” për ndjekjen penale të një numri të madh të studentëve nga Maqedonia me arsyetimin e marrjes pjesë në demonstratat armiqësore.

<sup>2023</sup> ДАРМ.1.427.520.22/251-257.

<sup>2024</sup> “Rilindja”, 1 tetor 1982.

<sup>2025</sup> Lita, Qerim: “Çështja shqiptare në RSFJ 1981-1990”, Shkup, 2014, faqe 113.

gjuhën shqipe si dhe literaturën tjetër që botohej në Maqedoni. Këto masa raciste u përcollën me reagimet e pritura të intelektualëve dhe të arsimtarëve shqiptarë, të cilët nuk u pajtuan me këtë, paçka se kjo u dha shkas zyrtarëve maqedonas për të ushtruar represion ndaj gjithë atyre që kundërshtonin, duke i akuzuar për “veprimtari armiqësore nga pozitat e nacionalizmit dhe të irredentizmit shqiptar”.<sup>2026</sup>

Veprimtaria ekstreme antishqiptare, e paparë deri më atëherë, kundër identitetit shqiptar si dhe qenies së tyre, përfshiu edhe rrënimin e lagjeve shqiptare, pastaj muret dhe rrethojat e shtëpive të tyre me pretekstet “e shëmtimit të ambientit” si dhe varrezat, ku epitafet duhej të shkruheshin me shkronja cirilike!<sup>2027</sup>

Kjo politikë e kulturocidit më të pashembullt, mori përmasat raciste me Rezolutën e Kuvendit Republikan të Maqedonisë për politikën e krijimit të familjes, me të cilën familjes shqiptare i ndalohej të ketë më shumë se tre fëmijë!<sup>2028</sup>

Me këtë rezolutë, madje, prindërve shqiptarë iu ndalohej t’i emërtojnë fëmijët e tyre me emra që kanë karakter dhe domethënie nacional shqiptare si : Kushtrim, Liridon, Kastriot, Arbëreshë, Alban, Albana, Vlora, Shkodra e të tjera!<sup>2029</sup>

Në këto rrethana, kur fushata kundër shqiptarëve po merrte edhe përmasa të papara raciste, me të cilat, krahas identitetit etnik, prekej edhe ai njerëzor, ishte i natyrshëm edhe reagimi i shqiptarëve, ndonëse jo në përmasat e pritshme.

Por, Shkupi zyrtar, ishte i përgatitur që reagimet e shqiptarëve për të mbrojtur identitetin e tyre njerëzor, t’i kualifikojë si shprehje e “veprimtarisë armiqësore” nga “pozitat e nacionalizmit dhe të irredentizmit shqiptar”, me ç’rast, edhe format individuale të reagimeve lidheshin me veprimtarinë e “organizatave armiqësore”, të shumtën të sajuara nga policia e shtetit e specializuar tashmë për fabrikimin e “irredentistëve shqiptarë” sipas skenarëve të njohur të Beogradit, të lidhur kryesisht me ideologjinë staliniste dhe Shqipërinë enveriste, për ç’gjë, shqiptoheshin dënime të shumta me heqje lirie nga një deri në dhjetë vjet.<sup>2030</sup>

---

<sup>2026</sup> По аты, фаце 115.

<sup>2027</sup> ДАРМ.1.1427.519.13-318-341.

<sup>2028</sup> ДАРМ.1.142.45/517-547.

<sup>2029</sup> ДАРМ.1.427.520.33/258-340 – Закон за изменување и дополнување на Законот за личното име, „Сл. Весник на СРМ, бр.41/85: “Neni 1: Në ligjin për emrin personal (Gaz, zyrtare e RSM” nr. 30/72) në nenin 1 paragrafi 1 shtohet paragrafi i ri, ku thuhet: “*Me emrin personal nuk guxon të nxitet urrejtje nacionale apo fetare, apo jottolerancë ose të fyhet morali publik*”. Neni 2: Në nenin 3 pas paragrafit 2 shtohet paragrafi i ri, ku thuhet: “*Në librin e amzës të lindjes nuk mund të regjistrohet emri personal me të cilin nxitet urrejtja aapo jotoleranca nacionale apo fetare*”; Neni 3 – në nenin 8 pas paragrafit 1 shtohet paragrafi i ri ku thuhet: “*Ndryshimi i emrit personal, përkatësisht emrit ose i mbiemrit nuk mund të jepet pëlqim nëse me ndryshimin nxitet urrejtja ose jotoleranca nacionale apo fetare apo ofendohet morali publik*”. (Shih: Lita, Qerim: “*Çështja shqiptare në RSFJ 1981-1990*”, Shkup, 2014, faqe 113/114).

<sup>2030</sup> Në periudhën 1981-1988 gjykatata maqedonase dënuan penalisht 37 shqiptarë për veprimtari armiqësore, nga 113 prej të cilëve u burgosen, të përfshirë në organizata të ndryshme të cilat cilësohen armiqësore nga

## MAQEDONIA PËRKRAH POLITIKËN E MILLOSHEVIQIT PËR RRËNIMIN E AUTONOMISË SË KOSOVËS

Fushata dhjetëvjeçare antishqiptare në Maqedoni (1981-1991), krahas kulturocidit e deri te racizmi i hapur, që doli nga Rezoluta e Kuvendit të Maqedonisë për politikën e krijimit të familjes,<sup>2031</sup> krahas diskriminimit të hapur në jetën shoqërore, politike dhe atë ekonomike, pati edhe dimensionin “jugosllav”, për rrënimin e autonomisë së Kosovës, që njëherësh shfaqej edhe interes thuajse “jetik” për Maqedoninë, ngaqë autonomia e Kosovës nën Serbi atë e lironte nga “trysnia” e bashkimit shqiptar në hapësirën jugosllave. Nëse Kolishevski, Mojsovi, Andovi, Cërvenkovski e të tjerët si ata, nga shpërthimi i demonstratave të Prishtinës, në mas të vitit 1981, ndihmuan që me aprovimin e platformave partiake dhe vendimeve të tjera në forumet federative (Kryesinë e Partisë, të RSFJ-së dhe Kuvendin Federativ), t’i krijohet baza shoqërore dhe politike dhe ajo ligjore fushatës antishqiptare në të gjitha nivelet, Maqedonia, ndër të parat dhe me shumë përkushtim, iu bashkua fushatës së Millosheviqit për rrënimin e autonomisë së Kosovës. Siç dihet, në vitin 1986, Kryesia e RFSJ-së, nën tryshninë e vazhdueshme të Beogradit, doli me qëndrimet për ndryshimet kushtetuese në federatën - jugosllave, që ato të bëheshin në kapitullin që i rregullonte politikën ekonomike për të krijuar kushtet për reforma ekonomike pa prekur kapitujt që ndryshonin karakterin e federatës jugosllave e përbërë nga gjashtë republika dhe dy krahina (Vojvodina dhe Kosova që njëherësh ishin edhe në përbërje të RS të Serbisë).

Por, siç do të shihet, Serbia, e cila kërkonte që ndryshime kushtetuese të preknin pikërisht karakterin e federatës, paralelisht me hapjen e kësaj çështje, kishte filluar përgatitjet që të krijojë rrethanat e nevojshme që ndryshimeve të kushtetutës t’ua imponojë edhe qëndrimin serb, që me anën e tyre të rrënohej përfaqësimi i autonomive në federatën jugosllave me arsyetimin se “Serbia duhej të barazohej me republikat tjera në federatë”, pra të përfaqësohej pa krahinat.

Ndër këto “rrethana të favorshme” për ndryshime kushtetuese, gjithsesi se ishin ato që lidheshin me politikën e kuadrove në Kosovë, me ç’rast vendin e Fadil Hoxhës në Kryesinë e RSFJ-së, duhej ta zinte Sinan Hasani, ndërsa në Kryesinë e Partisë Kosovën ta përfaqësojë Ali Shukriu. Sinan Hasani dhe Ali Shukriu kishin

---

pozitat e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar. Të tilla paraqiten organizatat “Partia Popullore e Punës” (me 19 anëtarë), “Shpella” e Tetovës me 77 anëtarë, 17 prej tyre të dënuar penalisht, “Kushtrimi i lirisë”, pastaj anëtarët e “Grupit Marksist-leninist të Kosovës” e të tjerë. (Shih: ДАРМ.1.427.515.16/300-331, СТРОГО ПОВЕРЛИВО, ЕБ.бр.41, АНАЛИЗА, te Lita, Qerim: „Çështja shqiptare në RSFJ 1981-1990”, Shkup, 2014, f. 115).

<sup>2031</sup> Lita, Qerim: “Çështja shqiptare në RSFJ 1981-1990”, Shkup, 2014, faqe 113.



qenë ndër politikanët thuajse të pensionuar, të cilët, pas shpërthimit të demonstratave të vitit 1981, kishin mbështetur vlerësimet e Serbisë për “për shpërthimin e kundërrevolucionit” në Kosovë mbi pozitat e “nacionalizmit dhe të irredentizmit shqiptar” si dhe karakterin “armiçësor” të kërkesës për Republikën e Kosovës. Duke mbrojtur qëndrimet e Beogradit, edhe njëri dhe tjetri, gjithë fajin ua kishin hedhur “udhëheqjes politike të Kosovës”, sidomos F. Hoxhës dhe M. Bakallit. Sinan Hasani, madje, kishte shkruar edhe një libër “për gjenezën e kundërrevolucionit” në Kosovë, që ai e lidhte me “pretendimet për Shqipërinë e Madhe”.<sup>2032</sup>

Ndaj, Serbia, jo rastësisht kishte pritur ardhjen e S. Hasanit në Kryesinë e RSFJ-së, që propozimi për ndryshime kushtetuese, me të cilat Serbisë do t’i kthehej “identiteti shtetëror në gjithë territorin e vet”, të inicioheshin nga “përfaqësuesi shqiptar” i Kosovës në kryesinë e shtetit, me çka, edhe “Kosova i kthehej realitetit politik”, pra heq “pretendimet irredentiste, që prodhon kërkesa për Republikën e Kosovës si pjesë e strategjisë për krijimin e Shqipërisë së Madhe”, e mbështetur edhe nga Shqipëria.<sup>2033</sup>

Po ashtu, fillimi i fushatës për ndryshimet kushtetuese, në Beograd kishte nxjerrë në skenën politike serbe, Slobodan Millosheviqin – politikanin ekstremist, i cili u fuqizua në krye të politikës serbe në saje të kursit të njohur nacionalist ndaj Kosovës, të mbështetur në lëvizjen e njohur populliste të serbëve të Kosovës, me të cilën kishte filluar fushata tetëmbëdhjetë muajsh për rrënimin me dhunë të autonomisë së Kosovës, që do të përmbyllet më 23 mars 1989.

Millosheviqi, në Mbledhjen e Tetë të KQ të LK të Serbisë, ia doli që të krijojë një atmosferë populliste, me të cilën eliminoi që të gjithë ata që nuk mendonin si ai, pra që Jugosllavisë t’i imponohej kursi i diktatit të politikës unitariste dhe nacionaliste me të cilën federata jugosllave do të detyrohej të pranonte kursin e saj. Pas heqjes së Ivan Stamboliqit, R. Pavllloviqit, B. Bogdanoviqit dhe të tjerëve, Millosheviqi iu kthye lëvizjeve populliste në Kosovë, që me anën e tyre të imponojë ndryshimet kushtetuese, me të cilat ndryshohej karakteri i saj, pra që krahinat autonome “t’i ktheheshin” prapë Serbisë, në mënyrë “që ajo të jetë e barabartë me të tjerat”. Me lëvizjen serbe të Kosovës, filloi edhe i ashtuquajtimi “revolucion i jogurtit”, me të cilin, në fillim të vitit 1988, Millosheviqi ndërroi udhëheqjen politike në Vojvodinë si dhe atë në Mal të Zi, duke iu nënshtruar në tërësi kursit të tij popullist, si dhe iu vërsul Kosovës.

---

<sup>2032</sup> Hasani, Sinan: “Kosova - të vërtetat dhe mashtrimet”, Prishtinë, 1986.

<sup>2033</sup> Đaković, Spasoje: „Sukobi na Kosovu“, Beograd, 1983, faqe 123, 138, 228.

Natyrisht se në këtë betejë, të përgatitur mirë e mirë nga Memorandumi më i ri i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë si dhe me përkrahjen e Kishës Ortodokse Serbe, e cila mori përsipër pjesën “shpirtërore të fushatës”,<sup>2034</sup> Millosheviqi ia imponoi Jugosllavisë diktatin serb, që nënkuptonte sakrifikimin e krahinave (Kosovës dhe Vojvodinës), të cilat duhej të ktheheshin nën shtetullat e saj.

Në këto rrethana, krahas udhëheqjeve marionete që i vendosi në Vojvodinë dhe Mal të Zi si dhe “paqësimit” të asaj të Bosnjës dhe Hercegovinës që të ruajë “neutralitetin” në raportet në federatë që gjithnjë e më hapur po ia krijonin “bllokun” serb në Kryesinë e RSFJ-së, Maqedonia ndonëse “e kursyer” nga “stuhia e mitingashëve”, që rrëronte çfarë u dilte para, ishte rreshtuar e tëra në anën e Millosheviqit dhe politikës së tij për rikthimin e federatës jugosllave në “serbosllavi”.

Edhe këtu, për maqedonasit, kalkyli i Kosovës dhe rrënimi i autonomisë së saj luante rol vendimtar, ngaqë në këto rrethana kur Millosheviqi nëpërmes “revolucionit të jogurtit” ndërronte udhëheqjet republikane dhe krahinore sipas qejfit, Shkupi i kishte duart e lira që të “perfeksiononte” politikën antishqiptare me të gjitha mjetet dhe metodat që lejonte edhe fantazia më destruktive, siç ishin ato të etnocidit që nuk ishte parë deri më atëherë në Europën e pas luftës së dytë botërore si dhe aprovimi i ligjeve raciste, me të cilat shqiptarëve u ndalohej edhe nataliteti.

Meqë lëvizja populliste e serbëve në Kosovë, Vojvodinë, Mal të Zi, Bosnje dhe Hercegovinë po edhe Kroaci, e filluar në pranverën e vitit 1987 kishte zënë të shqetësojë gjithë vendin, po edhe faktorin ndërkombëtar dhe dihej se e gjitha nuk mund të përfundonte ndryshe pos me luftën tragjike, që nuk do të vonojë dhe do të ndizet, Maqedonia shfrytëzoi kohën e neurozës së luftës në njërën anë për ta intensifikuar fushatën antishqiptare në Maqedoni me të gjitha mjetet pa qarë kokën se për të mund të vihej në shënjestër të opinionit jugosllave e aq më pak të jashtëm që në fokus kishte veprimet e Millosheviqit, dhe në tjetrën anë, që t’i bëhej krah i pandashëm veprimeve me të cilat Millosheviqi kishte vu në

---

<sup>2034</sup> Kisha Ortodokse Serbe ishte inspirusja kryesore e lëvizjes populliste serbe me të cilën filloi rrënimi i autonomisë së Kosovës, po edhe i Jugosllavisë së Titos me anën e luftës. Në këtë lëvizje ajo drejtpërdrejt u kyç me rastin e shënimit të 600 vjtorit të shënimit të Betejes së Kosovës, duke i lëvizur eshtrat e Lazarit të rënë në atë betejë nga “tokat serbe” nga Knini nëpër Bosnje për të arritur në Kosovë, më 29 qershor 1989. Kjo fushatë disa muajshe kërcënonte kroatët, boshnjakët, malaziasit dhe veçmas shqiptarët, por asgjë nuk u ndërmor për parandalimin e saj, ngaqë të gjithë ishin pajtuar që “shpërthimi” i saj të ndodhë në Kosovë ku edhe kishte shpallur destinacionin e fundit. Në të vërtetë, më 29 qershor 1989, në Gazimestan të Fushë Kosovës, në praninë e udhëheqjes më të lartë jugosllave, para një milionë “mitingashëve”, të sjellë nga të gjitha viset e Jugosllavisë, Millosheviqi, me atë që tha se “Serbia me paqe, por edhe me luftë do t’ia dalë ta rikthejë të drejtën e vet”, pra që ta marrë drejtimin e Jugosllavisë, u promovua si “padron” i ri i politikës jugosllave, por edhe si zjarrvënës i luftës, që do të shpërthejë pas pesë vitesh, së cilës nuk do t’i shpëtojnë edhe ata që bënin sehir dhe kalkulonin hesapet e tyre (sllovenët, kroatët dhe boshnjakët).

shënjestër ndryshimin e kushtetutës së Jugosllavisë në përputhje me konceptin e tij që federata jugosllave të kthehej në një “Serbosllavi”. Për Maqedoninë, ishte e rëndësishme që të fitonte “garancione” që pozita e saj kushtetuese (republikë në federatë) nuk do të ndryshonte pa marrë parasysh se çfarë do të ishin raportet e ardhshme në të. Dhe, po ashtu, ishte e rëndësishme, se krahinat (sidomos Kosova) të fshihej nga përfaqësimi në federatë.

Arritja e këtyre qëllimeve për Maqedoninë ishte “interes nacional”, ndaj për të nuk kishte rëndësi fare si do të rreshtoheshin kroatët e sllovenët, që dihej se mund të largoheshin nga federata, e aq më pak si do të silleshin subjektet e tjera (Bosnja e Hercegovina dhe Mali i Zi) nën tutelën serbe. Për Maqedoninë, ishin të rëndësishme “garancitë” që ua jepte Beogradi se do të mbroheshin nga “invazioni” shqiptar në të gjitha variantet, edhe po qe se do të shpërthente ndonjë konflikt rajonal.

Edhe pse dihej se raportet e ardhshme midis Beogradit dhe Shkupit, për këta të dytët, nuk mund të ishin ndryshe pos të vasalitetit, maqedonasit, me sjelljen “lojale” ndaj Serbisë, nga viti 1981 e këndeje, kishin krijuar “kapital” të mjaftueshëm për t’u marrë në mbrojtje nga Beogradi, meqë ruajta e tërësisë së Maqedonisë Serbisë ia largonte mundësinë e përfshirjes eventuale të Bullgarisë, Greqisë si dhe Shqipërisë në këtë pjesë si dhe rrezikun që paraqiste skenari për copëtimin e saj.

Duke ditë këtë fakt si dhe rolin e politikës serbe në dominon e krizës jugosllave, politikanët maqedonas, do të mbështeten te Beogradi, të bindur se ajo i mbronte thujtë në të gjitha variantet: nga ai i fitores së tyre, po qe se Jugosllavia kthehej në “Serbosllavi”, por edhe te disfatës eventuale të Millosheviqit, nga shkaku se çfarëdo kthese politike serbe, për arsye gjeostrategjike në rajon, Maqedoninë do ta nxirrte të paprekur. Kjo ishte edhe e logjikshme, ngaqë copëtimi i saj, hapte krizë të re, në të cilën do të përfshiheshin Bullgaria, Shqipëria dhe Greqia, të cilën, sipas të gjitha gjasave, nuk do ta lejonin as amerikanët, që tashmë po përcillnin me vëmendje zhvillimet në Jugosllavi, që epilogu i saj assesi të mos e çonte gjëkund pos në sferën Perëndimore me Serbinë forcë rajonale, ose të përmasave të “pashallëkut të Beogradit”.

Në këtë konstalacion, Maqedonasit do të përcaktohen që t’u japin mbështetje të plotë kërkesave të Beogradit për ndryshime kushtetuese, paçka se ato preknin themelet e federatës jugosllave. Ndonëse Kolishevski nuk ishte më në funksionet kryesore në federatë, megjithatë, kursi i tij, i Cërvenkovskit dhe Gligorovit, nëpërmes Ll. Mojsovit (anëtar i kryesisë së Jugosllavisë dhe Kryetar i Këshillit Federativ për Mbrotje) vazhdonte të bartej edhe te garnitura “e re”, në të cilën dalloheshin “jugosllavët e moderuar” – V. Tupurkovski dhe të tjerë, të cilët, së

paku formalisht, përpiqeshin që në raport me sllovenët dhe kroatët, të ruanin njëfarë baraspeshe të interesave.

Kështu, në përcarjet që tashmë kishin përfshirë Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë, ku përfaqësuesit kroatë dhe sllovenë shfaqeshin gjithnjë e më të vendosur që partia, si fuqi udhëheqëse të mos ia japë bekimin “serbosllavisë” së Millosheviqit, ndërsa përfaqësuesit shqiptarë (A. Vllasi dhe K. Jashari) po zhvillonin betejën e fundit politike që “fuqia” e perënduar e “jugollavizmit” ta pengonte disi rrënimin e pozitës kushtetuese të Kosovës, megjithatë komunistë maqedonë, në momentet vendimtare, u rreshtuan në anën e Millosheviqit dhe kursit të tij të njohur kundër Kosovës po edhe kundër Jugosllavisë së Titos. Kjo u pa më së miri me rastin e demonstratave që shpërthyen në Kosovë në gjysmën e nëntorit 1988, me kërkesën që të mos lejohej ardhja në pushtet e vasalëve të Beogradit (Rr. Morinës, A. Shukriut dhe H. Azemit), me të cilët Millosheviqi, duke eliminuar A. Vllasin dhe K. Jasharin nga kreu politik i Kosovës, kërkonte rrënimin e autonomisë së Kosovës me “miratimin” që do ta merrte nga përfaqësuesit shqiptar, me çka para Jugosllavisë dhe botës, që me vëmendje përcillte epilogun e këtyre ndryshimeve në Kosovë, e gjitha të paraqitej si “vullnet i Kosovës”.

Meqë “vullneti” i Kosovës, shfaqej ndryshe, pra po kundërshtohej me të madhe dhe kjo u pa më së miri kur Azem Vllasi futi në lojë kartën e fundit të kundërshtimit të këtyre ndryshimeve nga vetë shqiptarët dhe se kjo u pasqyrua me grevën e minatorëve të “Trepçës” në shkurt 1989 por edhe me demonstratat e mëdhanë gjithë Kosovën, në të cilën u përfshinë mbi 500 mijë demonstrues, ndërkohë që Millosheviqi, në mitingun e njohur të Beogradit, para një milion serbëve, këtë e shfrytëzoi për ta kërcënuar Jugosllavinë se “mosviktimizimi” i Kosovës do të thoshte viktimizim i Jugosllavisë, gjë që e gjitha përfundoi me burgosjen e A. Vllasit si dhe shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në Kosovë, politikanët maqedonas, përfshirë edhe “të reformuarit” në krye me Tupurkovskin, kërkuan që autonomia e Kosovës të sakrifikohet “për ta shpëtuar” Jugosllavinë.

Pas rrënimit të autonomisë së Kosovës në mbledhjen e Kuvendit të Kosovës, më 23 mars 1989, kur Armata Jugosllave përdori tanket kundër demonstruesve në Prishtinë, Ferizaj dhe pjesët tjera të Kosovës, me ç’rast u vranë dhjetëra të rinj dhe shumë të tjerë u plagosën, Shkupi zyrtar, ndër të parët uroi Serbinë dhe përshëndeti rikthimin e Kosovës nën tutelën serbe, duke e quajtur “ngjarje të rëndësishme që rivendos baraspeshën e rrënuar kushtetuese në federatën jugosllave”.<sup>2035</sup>

---

<sup>2035</sup> “Нова Македонија”, Shkup, 24 mars 1989.

Për ndryshim nga qëndrimet kundërshtuese të Zagrebit dhe Lubjanës si dhe reagimet e krerëve politikë dhe partiakë sllovenë dhe kroatë, se “në Kosovë po varrosej Jugosllavia e AVNOJ-it”,<sup>2036</sup> dhe se kjo nuk do të pranohej assesit,<sup>2037</sup> përfaqësuesit maqedonë në federatën jugosllave (në kryesinë e RFSJ-së, atë të Partisë dhe Kuvendin Federativ), u rreshtuan në anën e Millosheviqit. Ky qëndrim nuk ndryshoi edhe atëherë kur soldateksa e Millosheviqit filloi luftën në Slloveni dhe Kroaci, me çka nisi shkatërrimi i pashmangshëm i Jugosllavisë, që si proces do të pranohet ndërkombëtarisht në Konferencën e Hagës të gushtit të vitit 1991.

Në këto rrethana dramatike po aq tragjike, Maqedonia, vazhdoi të jetë në anën e politikës antishqiptare të Beogradit. Krahas mbështetjes politikës luftënxitëse të Millosheviqit, Shkupi zyrtar, intensifikoi fushatën kundër shqiptarëve në Maqedoni në mënyrë që ata të përjashtoheshin nga shpallja e pavarësisë në bashkëveprim me politikën e Beogradit. Kjo hapi një kapitull të ri të mosbesimit dhe të armiqësisë me shqiptarët në Maqedoni dhe ata në Kosovë, që ndonëse iu deshën dhjetë vjet të kthehet në një luftë tjetër, siç ndodhi në vitin 2001, megjithatë ata nuk e penguan shpalljen e shtetit të pavarur të Maqedonisë nga shkak i vetëm se kur Kosova ndodhej e pushtuar nga Serbia, ndërsa Shqipëria në një tranzicion të mundimshëm, një Maqedoni jashtë luftës, përkundër hesapeve të hapura, shfaqej e dobishme edhe për çështjen e Kosovës dhe rrugën e saj drejt shkëputjes nga pushtimi serb.

---

<sup>2036</sup> “*Delo*”, Lubjana, 24 mars 1989, nga konferenca për shtyp e M. Kuçanit. Paraprakisht, janë të njohura deklaratat e Kuçanit, nga Cankarajev Dom në Lubjanë, të 22 shkurtit 1989, me rastin e solidarizimit me grevën e minatorëve të “Trepçes” rreth asaj se “në Trepçë po mbrohej Jugosllavia”, që Millosheviqit i kishte shërbyer si shkas për të nisur “mitingashët” e tij për në Lubjanë “për t’u shpjeguar e vërteta për Kosovën”, që nuk ishte tjetër pos “kërcënim” ndaj atyre që nuk pranonin sakrifikimin e Kosovës “për ta mbrojtur” Jugosllavinë.

<sup>2037</sup> “*Vjesnik*”, 25 mars, 1989, deklarata e I. Raqan, kryetar i Kryesisë së KQ të Kroacisë, i cili, për ndryshim nga Stipe Shuvar, anëtarë i Kryesisë së KQ të Jugosllavisë nga Kroacia, që mbante “qëndrim të ftohtë” ndaj ngjarjeve në Kosovë, kishte bërë të ditur se “rrënimi i autonomisë së Kosovës si dhe inferioriteti i treguar ndaj saj do të ketë pasoja jo vetëm për Kosovën, por edhe për të tjerët në federatën jugosllave, ngaqë Millosheviq nuk do të ndalet me aq”. Kjo kishte bërë që Raqan dhe Kuçan, në Plenumin e ardhshëm të KQ të LKJ-së të mos e pranojnë diktatin e Millosheviqit, me çka filloi edhe rrënimi i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë e me të edhe procesi i shpërbërjes së Jugosllavisë.

## KAPITULLI I KATËRT

### MAQEDONIA SHTETI I PAVARUR

#### SHTETI MAQEDON I KTHEN SHQIPATRËT NË PAKICË

Krijimi i republikës së Maqedonisë nga komunistët jugosllavë në fund të luftës së Dytë Botërore si dhe përfshirja e njëanshme në shtetin e ri federativ jugosllav,<sup>2038</sup> me pranimin e “popullit maqedonas” (një konglomerati identitetesh nga ai bullgar, vllah dhe sllav mbi përkatësinë e krishterimit ortodoks)<sup>2039</sup>, politikisht e shkëputi nga “opsioni bullgar”, por jo edhe nga anatema e një “krijese artificiale”, që e i vinte sa nga një emërtim gjeografik jashtë realiteteve historike, që i referohej antikitetit, e sa nga kthimi i shqiptarëve etnik në pakicë (pjesëmarrja e të cilëve kapërcen 30% e gjithëmbarshtëm të popullatës), pa përfshirë këtu edhe shqiptarët e besimit ortodoksë, me një shtrirje të gjerë, të asimiluar dhunshëm në serbë pas pushtimeve serbe nga viti 1912 e këndeje.<sup>2040</sup>

Ky diskurs u përsërit edhe në vitin 1991, me rastin e shpalljes së deklaratës për pavarësi nga kuvendi i Maqedonisë shtet të kombit maqedonas, me çka, praktikisht, do t’i krijohen rrethanat kryengritjes që plasi në Tanushë, në fillim të vitit 2001, si një luftë e papërfunduar rreth një shteti të pabarabartë.

Në të vërtetë, lufta e papërfunduar dhe shteti i pabarabartë nxjerrin në pah gjithë problematikën shqiptare në Maqedoni, ku *opsioni i barazisë*, i mbështetur mbi të drejtën historike dhe autoktoninë nga antikiteti e këndeje, shfaqet si *faktor krize*,

---

<sup>2038</sup> Republika e Maqedonisë e dalë nga Kuvendi i ASNOM-it (KAÇKM), në federatën jugosllave u pranua në Mbledhjen e Tretë të AVNOJ-it, në Beograd në nëntor të vitit 1945, me rastin e konstituimit të Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, e përbërë nga gjashtë republika – njësi federative (Serbia, me krahinën e Vojvodinës dhe “oblastin” e Kosovës, Kroacia, Sllovenia, Mali i Zi, Maqedonia dhe Bosnja e Hercegovina”).

<sup>2039</sup> Cvijić, Jovan: „*O etnografiji makedonskih slovena*“, Beograd, 1906, faqe 9-11 dhe Oestreich, K: “*Die Bevölkerung von Makedonien*”, te Georg. Zeitschrift 1905, faqe 285).

<sup>2040</sup> Rreth shqiptarëve ortodoksë në Maqedoni, më gjerësisht shih: Cvijić, Jovan: „*O etnografiji makedonskih slovena*“, Beograd, 1906, faqe 9-11; Oestreich, K: “*Die Bevölkerung von Makedonien*”, te Georg. Zeitschrift 1905, faqe 285); Schmitt, Oliver Jens: “*Kosova – historia e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*”, Prishtinë, 2012; Prifti, Kristaq: “*Popullësia e Kosovës 1831-1912*”, Tiranë, 2014; Sinadinovski, Beanislav: “*Shqiptarët ortodoks në Republikën e Maqedonisë*”, Shkup, 2015 dhe “*Josif Bageri – rilindësi, politikani dhe publicisti i madh shqiptar*”.

në vend që të ishte e kundërta. Dhe, për të qenë paradoksi edhe më i madh, është pikërisht koncepti i barazisë, që shfaqet kundërthënës, ngaqë në njërën anë “e kushtëzon” shtetin (opsioni shqiptar), dhe në tjetrën anë, e rrezikon (opsioni maqedonas)!

Ky pozicionim, vështirë i kuptueshëm, veçmas në kohën e tranzicioneve që kishte përfshirë edhe botën lindore, e cila po u kthehej postulateve civilizuese me barazinë si themel i të gjithave, pa mëdyshje se gjenezën e ka te diskursi politik nga fundvitet e tetëdhjeta dhe i fillimviteve të nëntëdhjeta dhe fryma e hegjemonizmit mbi fetishin e shtetit-komb, i dalë nga fryma e Memorandumit i fundit i Akademikëve serbë të Beogradit,<sup>2041</sup> që ushqeu krizën e federatës së përbashkët jugosllave dhe përfundimisht e solli atë deri të shkatërrimi tragjik dhe i përgjakshtëm, që për fat, Maqedoninë jo vetëm që e kurseu, por edhe e nxori fitimtare, nga që e shpalli shtetësinë, që si do të shihet edhe e mbrojti nga dridhjet e jashtme, por jo përgjithmonë, përkundër parashikimeve se do të jetë pikërisht Maqedonia dhe pozita e shqiptarëve atje, që do ta kthejë në një fuqi baruti.<sup>2042</sup>

Kur përmendet diskursi i frymës memorandumiane ndaj shqiptarëve si dhe pozitës së tyre politike, gjithsesi se kihet parasysh pikërisht qasja e politikës ma-

---

<sup>2041</sup>Memorandum i fundit i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve u shfaq në opinionin jugosllav në nëntor të vitit 1986. I mbështetur nga idetë e njohura hegjemoniste të akademikut Dobrica Qosiq, i njohur për kursin e tij antishqiptar nga viti 1968, kur edhe u përjashtua nga KQ i LK të Serbisë, Memorandumi, kërkonte që në emër “të rikthimit të dinjitetit shtetëror Serbisë”, që i ishte marrë “me autonominë e vitit 1974”, dhe “vlerësohet si një krijesë artificiale të Titos kundër Serbisë”, Kosovës t’i heqet autonomia e bashkë me të të gjitha institucioneve të arsimore dhe kulturore (Universitetit, Akademisë së Arteve, Rilindjes, instituteve) t’u hiqet karakteri kombëtar, ngaqë ato kanë prodhuar indoktrinimin nacionalist mbi bazat e ideologjisë shqiptaro-madhe, që ishte pasqyruar edhe me kërkesën “kundërrivolucionare” për Republikën e Kosovës. Në Memorandum, i bëhet thirrje edhe Maqedonisë, që të “shuajë të gjitha vatrat e nacionalizmit shqiptar atje”, veçmas të ndërpresë lidhjet kulturore dhe arsimore të shqiptarëve të Maqedonisë me ata të Kosovës, ku ata ktheheshin në irredentistë të shfrenuar! Fryma e Memorandumit të akademikëve serbë do të kthehet në platformë ekzekutive të politikës së Beogradit me ardhjen e Millosheviqit në pushtet, kur edhe do të fillojë fushata e tij e njohur për ridefinimin e federatës jugosllave në përputhje me interesat serbe, pra te një politike unitarsite dhe hegjemoniste, e cila hapin e saj të parë do ta dëshmojë në Kosovës, me rrënimin e autonomisë, më 23 mars 1989, me çka, nga maji i vitit 1991, me sulmin e armatës jugosllave të drejtuar nga serbët ndaj Sllovenisë, (mbas pak do të përhapet edhe kundër Kroacisë dhe një vit më vonë edhe kundër Bosnjës dhe Hercegovinës), fillon edhe rrënimi i federatës jugosllave.

<sup>2042</sup> Shih: Gustav, Karl Ström: “*Jugoslawien one Tito*”, Berlin, 1979. Publicisti i njohur gjerman dhe botues i gazetës me renome “Die Welt”, në një libër voluminoz, parashikon fundin e pashmangshëm të Jugosllavisë së Titos, mbas vdekjes së Titos, që do të ishte edhe tragjik. Këtë vlerësim e mbështet mbi dy faktorë: hegjemonizmin serbomadhe të ndërlikur me unitarizmin, që ushqehet nga Moska, e interesuar që pas Titos të rikthejë pozitën e veta atje të humbura nga viti 1949, si dhe kërkesën e shqiptarëve, që ai e quante të drejtë, për statusin e republikës në kuadër të federatës jugosllave. Te republika e Kosovës si republikë të shqiptarëve të Jugosllavisë, Schtröm shihet edhe mundësinë e ristrukturimit të federatës jugosllave, që mund ta shpëronte nga unitarizmi serb. Në kuadër të këtij rikonstruimi, autori gjerman, parashihet edhe përfshirjen e shqiptarëve të Maqedonisë në këtë republikë. Zhgjidhja e vetme që Maqedonia të mbetet e papërfshirë nga tektonizmat nacionale, e me këtë edhe federata jugosllave ashtu si është, mbetet që, krahas Republikës së Kosovës, shqiptarëve atje t’u pranohet statusi i barabartë me maqedonasit, gjë që kjo nuk do të lejohet as nga maqedonasit, as nga Serbia, po as nga Bullgarët dhe Grekët, që kanë pretendime ndaj Maqedonisë. (Shih: “Memorandum SANU”, te revista “Naše teme”, 33, 1-2, Zagreb, 1989, faqe 128-163).

qedonase në procesin e shtetndërtimit, pra të rrethanave, që e kushtëzuan atë, siç ishin ato që u shfaqen me fillimin e luftës në ish Jugosllavi (sulmi i armatës jugosllave ndaj Sllovenisë në maj 1991) si dhe mbajtja e Konferencës së Hagës, në gusht të vitit 1991, me ç'rast, Jugosllavia shpallet shtet në shpërbërje, proces ky që do të mbikëqyret nga Komisioni i Badinterit.<sup>2043</sup>

Maqedonia e kursyer qëllimisht nga politika luftënxitëse e Millosheviqit, rastin për t'u shkëputur nga federata jugosllave, e shfrytëzoi që shtetin e pavarur ta ngritë mbi konceptin ekskluziv nacional, pra atë maqedonas, edhe pse realitetet etnike, po edhe ato historike, që lidheshin me faktorin shqiptar, e përjashtonin atë jo vetëm nga shkaku i pjesëmarrjes së tij me mbi 30% në numrin e përgjithshëm të popullatës, por edhe me statusin e deritanishëm shoqëror dhe politik në të në përputhje me kushtetutën e vitit 1974, të barabartë me të tjerët, pra edhe me maqedonasit.<sup>2044</sup>

Kjo rrugë, që Maqedoninë do ta çojë drejt krizave të ardhshme dhe të pashmangshme deri te ajo e vitit 2001, nisi me Deklaratën e Pavarësisë, e cila u soll në Kuvendin e Maqedonisë, më 25 janar 1991.

Ky akt ishte hapi i parë politik drejt mëvetësisë së Maqedonisë shtet i pavarur. Mbi bazat e saj u ndërtua të gjitha aktet e mëvonshme të shtetit të ri. Mirëpo, Deklarata nuk e shprehte realitetin shumetnik të Maqedonisë, ngaqë politika maqedonase filloi të shpalosë platformë nacionale, të mbështetur mbi një realitet të shtrembëruar historik dhe etnik në kundërshtim me aspiratat e popullit shqiptar në Maqedoni si etni historike dhe kulturore me rrënjë në antikitet, që nga ky këndvështrim, shfaqej e vetmja me të drejtën historike.<sup>2045</sup>

Deklarata për Pavarësinë, shtetin e pavarur të Maqedonisë, e mbështeste mbi *“integritetin territorial të shtetit maqedonas”* dhe mbi *“të drejtën e popullit maqedonas për vetëpërcaktim”* (Neni i Deklaratës).<sup>2046</sup>

Ky formulim, i shikuar njëanshëm dhe jashtë kontekstit historik dhe etnik të një formulimi politik mbi baza gjeografike, shqiptarët i përjashtonte nga shtetë-

---

<sup>2043</sup> Konferenca e Hagës, e iniciuar nga Bashkimi Europoian, u mbajt në gusht 1991 në Hagë.

<sup>2044</sup> Shih Preambulën e Kushtetutës së Maqedonisë të vitit 1974, ku ajo definohet:

*“Republika Socialiste e Maqedonisë është shtet nacional i popullit maqedonas dhe shtet i kombësisë shqiptare dhe turke në të, bazuar në sovranitetin e popullit, pushtetit dhe vetëqeverisjes së klasës punëtore dhe të gjithë njerëzve punonjës dhe bashkësi socialiste demokratike vetëqeverisëse të popujve punonjës dhe qytetarëve, të popullit maqedonas dhe me të, të barabartë të kombësisë shqiptare dhe turke”*. (“Службени весник на Социјалистичка Република Македонија”, Но. 7, 25.02.1974, стр.498).

<sup>2045</sup> Rexhepi, Zeqirja, *“Zhvillimet politiko-shoqërore të shqiptarëve të Maqedonisë, 1990-2001”*, Tetovë, 2005, faqe 31.

<sup>2046</sup> Shih Neni 1: *“Me këtë deklaratë shprehet sovraniteti i Republikës Socialiste të Maqedonisë në pajtim me përcaktimet kushtetuese për pavarësinë dhe integritetin territorial të shtetit maqedonas, si dhe të drejtën e popullit maqedonas për vetëpërcaktim, duke e inkuadruar edhe të drejtën për shkëputje”*.



sia. Ata, me të drejtë, bojkotuan Referendumin e 8 shtatorit 1991 në mënyrë që t'i kontestohet legjitimiteti demokratik një konstrukti tjetër politik, por nuk ishin në gjendje që ta parandalonin një veprim të tillë.

Megjithatë, pyetja e shtruar në Referendum: *“A jeni për Maqedoninë si shtet sovran me të drejtë që të hyhet në Lidhjen e shteteve sovrane të Jugosllavisë?”*<sup>2047</sup> si pyetje, nuk do të duhej të ishte kontestuese edhe për shqiptarët, po qe se ajo do të shikohej e shkëputur nga Deklarata për Pavarësi si dhe ato që do të pasojnë mbas saj (zgjedhja e kryetarit të Kuvendit të Maqedonisë, Kiro Gligorovit dhe të qeverisë së Maqedonisë si dhe prononcimet e Grupit të Intelektualëve Maqedonas të Shkupit të përfshirë në të ashtuquajturin “Forum Maqedonas”<sup>2048</sup>), me të cilat do t'i krijohet platforma Kushtetutës së Maqedonisë, që do të miratohet në kuvendin republikan, më 17 nëntor 1991.

Preambula e saj, konfirmoi platformën e Deklaratës së Pavarësisë nga 8 shtatori 1991 rreth shtetit maqedonas si shtet kombëtar i maqedonasve,<sup>2049</sup> ndonëse jashtë çfarëdo lidhjeje me realitetet historike me etninë etnike antike maqedonase, e ku shqiptarët, si etni e drejtpërdrejtë historike nga antikiteti e këndeje të ndërlidhur me mbretërinë Maqedonase dhe atë dardane në kuadër të amëzës pellazge-ilire, degradohen, në “pakicë”.<sup>2050</sup>

Degradimim i statusit të shqiptarëve nga ai shtetformues, që e kishin në kushtetutën e vitit 1974 në “pakicë” në atë të shtetit të pavarur, gjithsesi se

---

<sup>2047</sup> Глигоров, Киро: „Македонија е се што имаме“, Shkup, 2002, faqe 202.

<sup>2048</sup> “*Forumi Maqedonas*” u iniciua nga Gligorovi në vitin 1989 dhe u drejtua nga Petar Goshev (Kryetar i Komitetit Qendror të LK të Maqedonisë) në kohën kur vëreheshin shenjat e shkatërrimit të ish Jugosllavisë. Me fillim e këtij procesi, që t’u jepeshin përgjigje çështjeve esenciale të maqedonasve dhe të Maqedonisë, Gligorovi, zgjeroni rrethin me akademikë, intelektualë dhe të tjerë, duke u fokusuar te problematika e shtetit të pavarur maqedonas, që duhej të shpallej së shpjeti. Ashtu, siç kishin vepruar edhe akademikët serbë me rastin e Memorandumit të fundit, në vitin 1986, edhe maqedonasit ishin përqendruar te aspekti nacional, duke e parë maqedoninë vetëm si shtet të kombit maqedonas. Edhe pse do të mungojë gjuha e urrejtjes ndaj shqiptarëve, megjithatë, ata do të trajtohen vetëm si “pakicë”, historia e të cilëve “është e mjegulluar”, si “mbetje ballkanike”, siç paraqitej nga Çubrilloviqi, Gjorgjeviqi e Qosiqi. (Shih: Глигоров, Киро: „Македонија е се што имаме“, Shkup, 2002).

<sup>2049</sup> Shih Preambula e Kushtetutës së Maqedonisë: *“Nisur nga trashëgimia historike, kulturore dhe shpirtërore e popullit maqedonas dhe të luftës shekullore për çlirim nacional dhe social dhe për krijimin e shtetit të vet, e veçanërisht nga tradita juridike-shtetërore të Republikës së Krushevës dhe vendimet historike të ASNOM-it dhe kontinuitet juridiko-kushtetues të Republikës sovrane në Jugosllavinë Federative, prej vullneti të lirë të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë në Referendumin e 8 shtatori 1991, sikurse edhe nga fakti historik se Maqedonia është konstituuar si shtet nacional i popullit maqedonas në të cilin sigurohen të drejtat e barabarta të qytetarëve dhe për bashkëjetesë të përhershme të popullit maqedonas me shqiptarët, turqit, vllahët, romët dhe nacionalitetet tjera të cilët jetojnë në Republikën e Maqedonisë”.*

<sup>2050</sup> Në Kushtetutën e vitit 1974 shqiptarët kishin pozitën e barabartë me maqedonasit dhe të tjerët. Republika e Maqedonisë cilësohej shtet i barabartë i kombit maqedon dhe i kombësisë shqiptare. (Службени весник на Социјалистичка Република Македонија, Но. 7, 25.02.1974, стр. 498).

kërkonte edhe reagimin e shqiptarëve, sidomos në rrethanat e përfaqimit të pluralizmit, kur ata, me “Partinë e Prosperitetit Demokratik” dhe “Partinë Demokratike Popullo-re”, merrnin pjesë edhe në jetën parlamentare dhe atë institucionale të vendit që nga zgjedhjet e para në nëntor të vitit 1990.<sup>2051</sup>

## REFEREDNMI PËR AUTONOMI DHE “ILIRIDA”

Natyrisht se shqiptarët në Maqedoni, kur Kosova tashmë ishte nën represionin e egër të regjimit të Millosheviqit si dhe kërcënimit të vazhdueshëm të bartjes së luftës edhe në atë pjesë, që do të kishte pasoja tragjike, dhe në rrethanat kur tranzicioni në Shqipëri në vend se të përmirësonte gjendjen në vend, ia kishte hapur rrugën një kaosi gjithëpërfshirës, nga frika se në trekëndëshin e shqetësuar shqiptar do të mbetej pa përkrahje dhe madje në skenën e lojërave të mëdha rajonale mund të sakrifkohet, u përcaktuar për “reagim demokratik”, për mbajtjen e një Referendumi për autonomi politike-territoriale të shqiptarëve, të quajtur “*Republika e Iliridës*”.

Në të vërtetë “reagimi demokratik” i shqiptarëve në Maqedoni ishte pjesë e një mendësie që detyrimisht u promovua në procesin e shpërbërjes së ish Jugosllavisë, pas rrënimit të autonomisë së Kosovës më 23 mars 1989. Nga ajo ngjarje e përgjakshme e këndeje, shqiptarët në hapësirat e ish Jugosllavisë, u rreshtuan bashkarisht rreth përgjigjes që duhej t’i jepej sfidës së rrënimit të Jugosllavisë, që shfaqej e pashmangshme. Në këto rrethana, ishte Kosova në rolin e një qendre, që merrte përgjegjësinë politike për fatin e shqiptarëve në mënyrë që të shfaqeshin në rolin e një subjekti, që do ta menaxhonte situatën në përputhje me interesat e veta.

Natyrisht se zhvillimet dramatike pas rrënimit të autonomisë së Kosovës dhe eliminimit të klasës së gjithëmbarshme të deriatëhershme politike, detyruan elitën

---

<sup>2051</sup> Në zgjedhjet e 11 nëntorit 1990 në Maqedoni, morën pjesë dy partitë shqiptare: “Partia për Prosperitet Demokratik”, e cila fitoi 17 deputetë dhe “Partia Demokratike Popullore” në koalicion me “Partinë për Prosperitet Demokratik” – 5 deputetë dhe “Partia Demokratike Popullore” 1 deputet. Fituese e zgjedhjeve ishte VMRO-DPMNE me 38 deputetë, e pasuar nga “Lidhja e Komunistëve të Maqedonisë – Partia për Transformim Demokratik”, me 31 deputetë. Deputetët shqiptarë që fituan në zgjedhjet e para pluraliste ishin: Hysni Shaqiri, Agim Fazliu, Shukri Rrahimi, Naser Zymberi, Eshref Alia, Shaban Prevalla, Naif Mustafa, Ismet Ramadani, Xheladin Murati, Muhamet Halili, Vehbi Xhemaili, Abdurrahman Aliti, Hamit Aliu, Ferit Sadiku, Naim Selmani, Zudi Emini, Xhelil Tahiri, Sefedin Haruni, Nexhat Xhaferi, Ollomon Sulejmani, Gazmend Hajdaraga, Mersim Pollozhani dhe Avdi Murtezani. Si shihet, partitë politike, injoruan në tërësi faktorin gjinor! Pra, në Kuvendin e Maqedonisë nuk pati asnjë femër shqiptare!

intelektuale të Kosovës përballë një përgjegjësie historike, e cila do të mund të legjitimohej vetëm me anën e krijimit të një partie politike, që do të jetë në gjendje të dalë me program politik. Kjo u mundësua me themelimin e “Lidhjes Demokratike të Kosovës” më 23 dhjetor 1989 në Prishtinë – partisë së parë shqiptare me përcaktim perëndimor.<sup>2052</sup>

Themelimi i “Lidhjes Demokratike të Kosovës”, zgjerimi i saj i shpejtë që u përcoll me rrënimin e strukturës komuniste në Kosovë dhe krijimin e një qendre politike të shqiptarëve, imponoi edhe nevojën që kjo parti, tashmë e kthyer në një Lëvizje kombëtare, të merrte përgjegjësinë edhe për organizimin politik të shqiptarëve në Maqedoni, në Luginë të Preshevës, në Mal të Zi dhe gjetiu në hapësirën jugosllave.

Ky organizim, megjithatë nuk ishte as i lehtë e as i thjeshtë, ngaqë u nënshtrorë rrethanave të caktuara politike dhe atyre administrative në të cilat ndodheshin shqiptarët, të cilat duhej pas parasysh në mënyrë që të mos bihej ndesh me to dhe sidomos me faktorët e jashtëm, që duhej ta mbikëqyrnin. Pra, kërkohet një strategji fleksibile rreth të gjitha opsioneve të mundshme që i impononte kriza e shpërbërjes së Jugosllavisë dhe kahu që mund të merrte ajo. Emërues i përbashkët, megjithatë, ishte organizimi politik i shqiptarëve në të gjitha njësitë administrative (Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi) me përfshirjen e tyre në parti politike, që do të ishin të ndërlidhura me “Lidhjen Demokratike të Kosovës”, një amze të përbashkët.

Kështu dhe do të ndodhë. Nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejt të “Lidhjes Demokratike të Kosovës”, në maj 1990, në Tetovë u themelua “Partia për Prosperitet Demokratike” në Maqedoni, ajo “Për veprim Demokratik” në Luginë të Preshevës, “Lidhja Demokratike e Malit të Zi” si dhe “Lidhja Demokratike në Kroaci”. Të gjitha këto parti, ishin pjesë e “Lidhjes” së Kosovës. Ato kishin përgjegjësi “lokale”, por edhe ishin pjesë e tërësisë. Kjo u funksionalizua me krijimin e “Këshillit të përbashkët të Partive Politike të Shqiptarëve në Jugosllavi”, me seli në Prishtinë, kryetar i së cilës u zgjodh Ibrahim Rugova, kryetar i “Lidhjes Demokratik të Kosovës”.

Në këtë aspekt, rol të veçantë kishte “Partia për Prosperitet Demokratik” e shqiptarëve në Maqedoni, së cilës, pas vendimeve të Konferencës së Hagës, të gushtit 1991, me ç’rast Jugosllavia u shpall në shpërbërje, i binte barra për pjesë-

---

<sup>2052</sup> Më gjerësisht rreth themelimit të “Lidhjes Demokratike të Kosovës” dhe programit të saj shih Buxhovi, Jusuf: “Kosova”, I-V, Prishtinë, 2015, libri V, faqe 216-228.

martje aktive në këtë proces, në mënyrë që në shtetin e pavarur të Maqedonisë shqiptarët të shfaqeshin si shtetformues.

Kjo nënkuptonte dy gjëra: së pari që shqiptarët e Maqedonisë të pajtoheshin me opsionin e shtetit të pavarur të Maqedonisë, që dilte nga Konferenca e Hagës, dhe së dyti, nënkuptonte edhe pajtimin e shqiptarëve të Kosovës me këtë fakt si dhe atyre të Shqipërisë, në mënyrë që zgjidhja e çështjes shqiptare të vihej në binarët demokratik.

Meqë shqiptarët e Kosovës ishin “anashkaluar” nga Konferenca e Hagës, e cila të drejtën e vetëvendosjes ua njihte vetëm republikave, por që me Deklaratë Kushtetuese të 2 korrikut 1990 dhe në Kuvendin e Kaçanikut të 7 shtatorit 1990 kishin shpallur republikën e Kosovës dhe ishin shkëputur nga Serbia, ndërsa shqiptarë e Maqedoni, ishin futur në jetën politike të Maqedonisë, iu sugjerua që të pranonin shtetin e pavarur të Maqedonisë, me kusht që të jenë subjekt i barabartë shtetformues si dhe maqedonasit. Kjo do t’u sugjerohet edhe nga Shqipëria, e cila, kishte përballë procesin e vështirë të tranzicionit.

Në këto rrethana do të fillojë edhe procesi i inkuadrimin të shqiptarëve të Maqedonisë në jetën politike të Maqedonisë, në një fazë tepër të ndjeshme, kur në njërin anë Jugosllavia përfshihej në flakën e luftës, dhe në tjetrën anë, Kosova, ndonëse kishte shpallur pavarësinë dhe rikupimit serb i ishte përgjigjur me organizimin e shtetit paralel, si formë e rezistencës institucionale paqësore, unike në Europë, ndodhej përballë një kërcënimi të përfshihej në një luftë që mund të kishte pasoja tepër të rënda, ndaj së cilës nuk do të mund të bënin sehir as shqiptarët e Maqedonisë.

Dhe, duke shfrytëzuar këto rrethana, që mund të ishin me pasoja të rënda për Kosovën dhe fatin e tyre po qe se do të gjendej midis dy frontesh (atij serb dhe maqedonas), Shkupi zyrtar gjithë veprimet politike që çuan te shpallja e shtetit të pavarur, ia nënshtroi konceptit *shtet-komb*, me ç’rast maqedonasit shpalleshin pronar të tij, ndërsa shqiptarët mbeteshin në rolin e një pakice. Politikanët maqedonas, duke u përcaktuar për opsionin *shtet-komb*, kishin bindjen se shqiptarët nuk kishin alternativë tjetër pos ta pranonin atë, sidomos kur ndodheshin përballë kërcënimit serb.

Të ndodhur përballë një gjendjeje të tillë, kur kërkohet të mbrohet por edhe të ndihmohet Kosova për ta jetësuar përcaktimin e saj të shtetit të pavarur, shqiptarët në Maqedoni pranuan sfidën e demokracisë, qoftë edhe me kompromise, të bindur se Maqedonia si shtet nuk do t’i nënshtrohet një aventure të rrezikshme që pavarësinë ta shikojë si çështje për vete, duke i përjashtuar shqiptarët prej saj.

Në të vërtetë, kështu edhe do të ndodhë. Shqiptarët, ndonëse do të pranojnë të hyjnë në qeverinë e parë, dhe realisht, me 23 deputetë paraqisnin një forcë të konsiderueshme të parlamentarizmit demokratik, do të injorohen dhe do të anashkalohen në gjithë procesin e shtetndërtimit, duke u trajtuar si pakicë.

Kjo bëri që shqiptarët të bojkotojnë referendumin për pavarësi që u organizua në shtator 1991, me ç'rast, maqedonasit, pa shqiptarë, i thanë “po” konceptit të *shtetit-komb*. Ndonëse kjo ia kontestoi legjitimitetin, maqedonasve nuk u pengoi që ta shpallin Maqedoninë *shtet të kombit maqedonas*, siç ndodhi në dhjetor 1991. Kjo madje, nuk u pengoi as faktorëve ndërkombëtar, që monitoronin këtë proces dhe madje i dhanë “notë kaluese”, ngaqë ishin të bindur se meqë shqiptarët e Kosovës ishin nën pushtimin serb, ndërsa Shqipëria nuk po ia dilte që të përballonte tranzicionin, kjo nuk do të kishte pasoja.

Natyrisht se përballë një realiteti të tillë, shqiptarët e Maqedonisë u përcaktuan për kundërpërgjigje demokratike, për një referendum në të cilin do të artikulohej vullneti politik për një autonomi brenda për brenda shtetit të Maqedonisë, të bindur se kjo mund të mjaftonte që bota demokratike si dhe faktori ndërkombëtar e tyre t'i trajtonte me seriozitet dhe në përputhje me parimet demokratike.

Referendumi u mbajt më 11 e 12 janar 1992. Atë e sollti Kuvendi i Autonomisë, më 27 dhjetor 1991, nga një grupim thuajse ad-hoc i shqiptarëve.

Qytetarët shqiptarë duhej të deklaroheshin rreh pyetjes:

*“A janë për Autonomi politike-territoriale të shqiptarëve në Maqedoni”.*

Prej gjithsejtë 383,539 votuesve, sa përfshinte lista e votuesve, për autonomi votuan 360.928, ose 99,9%, kurse vetëm 57 votues votuan kundër.<sup>2053</sup>

Pas përfundimit me sukses të referendunit, Kuvendi i Autonomisë e emëroi njësinë e re politike-territoriale, me emrin “Ilirida”, emërtim ky që nuk kishte të bënte me realitetet antike e as ato të mëvonshme, për faktin se politikisht dhe etnikisht kjo hapësirë ka lidhur vetëm mbretërinë e Maqedonisë dhe Mbretërinë e Dardanisë.<sup>2054</sup>

---

<sup>2053</sup> Rexhepi, Zeqirja: *“Zhvillimet politiko-shoqërore të shqiptarëve në Maqedoni, 1990-2001”*, Tetovë, 2005, faqe 58.

<sup>2054</sup> Sipas hartuesve të këtij projekti - *“Ilirida”* ishte emër i lumit që në kohërat antike i lagte brigjet e tri Mbretërive Ilire: Dardanëve, Paonëve dhe Enkelejve. Ky lum kalonte prej vendeve të fiseve Peneste, në rrethinën e Hiskanës antike dhe trevat Peone dhe derdhej në lumin Aks (Vardar i sotëm), në Dardani. Lumi Ilirida është lum i sotëm Treska. Kjo toponimi, nuk asocion me realitetet antike, meqë hapësira e Maqedonisë së sotme, historikisht dhe gjeografikisht në pjesën jugore i ka takuar mbretërisë së Maqedonisë, ndërsa në atë veri-perëndimore, nga Belizari antik (Velesi i sotëm), i ka takuar mbretërisë së Dardanisë, e ku Pajonët dhe Frigët (Brygët) merren si fise dardane. Në këtë aspekt, emërtimi Dardani, do t'i jepte peshë më të madhe etnike, po edhe politike, edhe për faktin se qytet kryesor Shkupi (Scupi antik) ishte kryeqytet i Dardanisë antike si dhe

“Ilirida” ndonëse si emërtim i sajuar jashtë konteksteve historike, duhej të përfshinte: Kumanovën me rrethinë, disa komuna të Shkupit, Tetovën me rrethinë, Gostivarin me rrethinë, Dibërën me rrethinë dhe Strugën me rrethinë. Në territorin e Republikës së Iliridës do të jetonte 1/3 e popullatës së Maqedonisë, e banuar me shumicë shqiptare.<sup>2055</sup>

Projekti i autonomisë parashihte edhe elaboratin për zgjidhjen e çështjes shqiptare në Maqedoni përmes Autonomisë politike territoriale. Projekti parashihte një periudhë transitore për Autominë nën mbikëqyrjen ndërkombëtare me qëllim të krijimit të kushteve për formimin e njësisë federale shqiptare brenda një shteti federativ shqiptaro-maqedonas. Sipas këtij projekti zgjidhja e çështjes shqiptare në Maqedoni, parashihej me formimin e shtetit binacional federativ me dy njësi federale, shqiptare dhe maqedonase.<sup>2056</sup>

Kuvendi për Autonomi politike dhe territoriale të shqiptarëve në Maqedoni hartoi edhe propozimin për ndryshimin e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, që iu dorëzua Kuvendit të Maqedonisë. Aty shtrohen shkaqet për ndryshimin e Kushtetutës, qëllimi për ndryshimin e Kushtetutës si dhe ndryshimet në preambulën e Kushtetutës, në disa nene të saj, përkatësisht në nenin 3, nenin 5, nenin 48, nenin 51 dhe nenin 52, të cilat në Kushtetutë do të inkorporonin Autominë shqiptare, Republikën Autonome të Iliridës.<sup>2057</sup>

Në fund të këtij dokumenti, thuhet:

*“Po qe se Kuvendi i Republikës së Maqedonisë nuk e aprovon propozimin për ndryshimin e Kushtetutës së Maqedonisë dhe nuk i përcakton dhe garanton kërkesat për Autonomi politike dhe territoriale të shqiptarëve në Maqedoni, do të detyrohem i që ta avancojmë përcaktimin tonë politik në përputhje me të drejtën natyrore, etnike dhe historike të popullit shqiptar për vetëvendosje”.*<sup>2058</sup>

Si shihet, faktori politik shqiptar, kërkesën drejtuar Kuvendit të Maqedonisë rreth ndryshimeve kushtuese, me të cilat duhej të përfillej vullneti i shqiptarëve nga referendumi për autonomi politike dhe territoriale në Maqedoni, e kishte për-mbyllë me një kërcënim të hapur, që ishte i drejtë nëse shkohet deri te ajo pikë.

---

kryeqytet i Vilajetit të Kosovës, në kohën kur atje do të shpallet edhe Katërbëdhejtë pikëshi i Hasan Prishtinës, që ia hapi rrugën pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912 në Vlorë.

<sup>2055</sup> Rexhepi, Zeqirja: “Zhvillimet politiko-shoqërore të shqiptarëve në Maqedoni, 1990-2001”, Tetovë, 2005, faqe 58.

<sup>2056</sup> Po aty.

<sup>2057</sup> Po aty, faqe 60.

<sup>2058</sup> Po aty, faqe 61.

Meqë Kuvendi i Maqedonisë nuk e përfilli këtë kërkesë, por edhe anatemoi atë si “separatiste” dhe “luftënxitëse”, mbetej që shqiptarët të reagonin. Vota e popullit i obligonte për diçka të tillë.

Por, doli se klasa politike shqiptare punën nuk e kishin marrë me seriozitetin e duhur, as kur e kishin shtruar kërkesën për Autonomi politike dhe territoriale dhe as kur ishin refuzuar, ngaqë në vend se të reagonin në përputhje me një strategji të hartuar më kohë dhe, duhej të nënkuptonte një kundërpërgjigje adekuate, qoftë edhe me veprim të njëanshëm drejt internacionalizimit të saj, partitë politike shqiptare, që e kishin vu në veprim këtë çështje dhe e kishin organizuar shpejt e shpejt, në të njëjtën kohë po zhvillonin negociata për pjesëmarrje në koalicionin qeveritar maqedonas.<sup>2059</sup>

Kjo u pa edhe në Kongresin e Partisë së Prosperitetit Demokratik, që u mbajt më 8 dhe 9 shkurt 1992 në Tetovë, pas Referendimit për Autonomi politike dhe territoriale të shqiptarëve në Maqedoni dhe njohjes së Maqedonisë nga Bullgaria, me ç’rast dolën në pah dy rryma. Njëra që e arsyetonte miratimin e Deklaratës së pavarësisë së Maqedonisë pa kushtin shqiptar, që zgjidhjen e çështjes shqiptare në Maqedoni e shihte brenda Republikës së Maqedonisë dhe miratimin e Kushtetutës. Ndërsa tjetra, kundërshtonte miratimin e Deklaratës për Maqedoninë sovranë, miratimin e kushtetutës dhe angazhoheshin për jetësimin e referendimit për Autonomi politike-territoriale të shqiptarëve në Maqedoni, që zgjidhjen e çështjes shqiptare në Maqedoni e shihnin brenda Maqedonisë së pavarur, por në një Maqedoni binacionale ose federale.<sup>2060</sup>

Te këto përçarje shqiptare çfarë ishte ajo e referendimit për Autonomi politike dhe territoriale rreth së cilës ishte marrë po-ja e 99,9 të shqiptarëve, faktori maqedonas, po edhe ai ndërkombëtar, pa gjithë jo seriozitetin e faktorit politik shqiptar, që një pune të nisur, siç ishte kërkesa për autonomi politike dhe territoriale, të mos i shkohet deri në fund dhe pa një unitet të brendshëm, nuk e pa të udhës që të ndryshojë kursin e filluar.

Përkundrazi, hyrja në koalicionin qeverisës, përçarja e “Partisë së Prosperitetit Demokratik” dhe ndarja në dy parti mbas pak (Partinë Demokratike Shqiptare të Arben Xhaferi, timonin e së cilës ai do ta marrë në vitin 1995, prej nga ai, në vitin 1997, do të futet edhe në koalicionet qeveritare me partitë nacionaliste maqedonase VMRO-DPMN, me kauzë antishqiptare), jo vetëm që e la në plan të dytë vullnetin e shqiptarëve të shprehur në referendum, por sikur u harrua fare.

---

<sup>2059</sup> Po aty.

<sup>2060</sup> Po aty, faqe 64.

Kjo bëri që pak nga pak të humbet besimi i shqiptarëve te subjektet e tyre politike deri në atë shkallë saqë të krijohet bindja se me atë sjellje nuk mund të ndikohet në ndërrimin e statusit politik dhe juridik të tyre në Maqedoni.

Në të vërtetë, këtu dhe te kjo çështje, duhet parë shkaqet e luftës që përfshiu Maqedoninë në vitin 2001, që në njërën anë u nxit nga koncepti shtetëror maqedonas për diskriminimin e shqiptarëve në institucionet e sistemit shtetëror edhe në rrethanat e demokracisë parlamentare, dhe në tjetrën anë u nxit nga sjelljet e papërgjegjshme të klasës politike shqiptare, të pasqyruara me përcaje të brendshme, që në vend se përkushtimin për arritjen e statusit të barabartë shtetformues në shtetin e përbashkët dhe çdo veprim t'ia nënshtonin kësaj çështje, do të përqendrohet që, si dekor të parlamentarizmit maqedonas dhe nën tutelën e partive politike nacionaliste maqedonase, pushtetin ta shfrytëzojnë për përfitime personale.

Kjo luftë, sigurisht se do të mund të shpërthente edhe më herët, po mos të ishin dy faktorë që do ta shtyjnë përpak, por assesi ta shmangin. Së pari, zhvillimet në Kosovë – në mënyrë që ajo të mos përfshihej në një luftë që ia impononte Beogradi dhe, edhe nëse kjo do të ndodhte siç ndodhi në vitet 1998/99 – të merrej në mbrojtje nga NATO-s. Dhe së dyti – zhvillimet në Shqipëri, ku tranzicioni jo vetëm që nuk po kryhej si duhej, por po merrte kahun e një kaosi, siç ndodhi në vitin 1997 kur shteti shqiptar u ballafaqua me një luftë qytetare, që ia rrezikonte edhe qenien dhe u desh ndërhyrja e NATO-s që ta mbronte nga vetëshpërbërja.

Përballë këtyre faktorëve, mund të thuhet se shqiptarët në Maqedoni, por jo edhe politikanët e tyre, u sollën thujse detyrimisht “përgjegjshëm”, ngaqë nuk u përfshinë në një konflikt të brendshëm të provokuar nga maqedonasit, të cilët kërkonin që ata të reagonin me ndonjë revoltë ose kryengritje, me të cilën Beogadit do t'i krijoheshin atu për ndërhyrje në Maqedoni, me çka çështja e Kosovës, kundruall hapjes së konfliktit në Maqedoni, do të zbehej ose do të humbte fare vëmendjen ndërkombëtare. Përkundrazi, shqiptarët në Maqedoni, edhe përkundër diskriminimit që përjetonin në rrethanat “e pralamentarizmit demokratik” në të gjitha aspektet, kur partitë e tyre merrnin pjesë thujse në të gjitha qeveritë dhe stoliseshin me poste ministrash dhe drejtorë në disa dikastere të shtetit e deri te ambasadorët, mund të thuhet, se në disa segmente, iu kthyen modelit të “shtetit paralel” që tashmë Kosova e kishte kthyer në kredo të rezistencës institucionale.

I tillë ishte krijimi i Universitetit Shqiptar të Tetovës, në dhjetor 1994, si kundërpërgjigje ndaj dhunës që ushtrohej ndaj të drejtës për arsimim në nivelet e shkollimit të lartë. Ngjashëm u veprua edhe në kulturë, me ruajtjen dhe orga-



nizimin e manifestimeve me frymë kombëtare si dhe botimin e veprave të rëndësishme letrare dhe shkencore, të cilat ishin ndërprerë nga shteti maqedonas.

Mbajtja dhe organizimi i Universitetit Shqiptar të Tetovës, i shpallur ilegal nga qeveria e Maqedonisë si dhe format tjera të manifestimeve kulturore të frymës kombëtare, në të vërtetë, shoqërinë shqiptare në Maqedoni e ndanë në dy pole. Atë *krahut legal-institucional*, rreth një pakice përfituese, që ndiqte linjën e pjesëmarrjes së shqiptarëve në jetën institucionale nëpërmes përfaqësimit të partive politike, që nuk sillte kurrfarë dobie pos përfitimeve personale të disa strukturave partiake në kulaçin e pushtetit të shumtën të koorupuar dhe në shërbim të politikës maqedonase. Dhe, atë të *krahut "institucional-ilegal"*, mbi konceptin e Maqedonisë shtet dy-etnëshë, në përputhje me referendumin e vitit 1992, të ndërlidhur me "Iliridën", që si alternativë mund ta kishte opsionin e bashkimit kombëtar.

Ky opsion hipotetik, që kishte pas shumicën, megjithatë, varej nga zhvillimet në Kosovë dhe epilogu i saj, nga qëndrimi i shtetit shqiptar në këtë çështje, e mbi të gjitha, varej nga faktori ndërkombëtar dhe planimetria e tij në raport me përgjigjen që duhej t'i jepte krizës së gjithëmbarshme, që kishte shkaktuar shpërbërja e ish Jugosllavisë si dhe rënia e komunizmit dhe shpërbërja e Bashkimit Sovjetik.

Në këtë rrethana kur faktori politik shqiptar jo vetëm që nuk ishte i bashkuar rreth një opsioni por edhe shfaqej i përçarë mbi konceptet "shtet demokratik multietnik", siç kërkonte Arben Xhaferi dhe PDSH-ja<sup>2061</sup> dhe "shteti i dy popujve të barabartë", siç animohej nga spektri tashmë jashtë politik (kryesisht nga qarqet intelektuale të lidhura me Universitetin e Tetovës),<sup>2062</sup> vëmendje të veçantë meritojnë, në njërën anë, raportet midis Maqedonisë dhe Kosovës, dhe në tjetrën anë ato të Shqipërisë me Maqedoninë, ngaqë në trekëndëshin Shkup-Prishtinë-Tiranë, faktori shqiptar, krizën rajonale mund ta mbante jashtë ndikimit që asaj përpiquej t'ia jepte Beogradi dhe aleatët e saj, ose ta kthente në faktor të saj, me shumë të panjohura dhe rreziqe për vetë çështjen shqiptare.

Në këtë kalkyl, Arbën Xhaferi, ruante "baraspeshën" e impotencës së faktorit politik shqiptar me "realizmin politik", të shumtën të kamufluar me "standardet demokratike", ku koncepti "i shtetit kombëtar", siç ishte ai maqedonas duhej "të transformohej nga brenda" në "shoqëri multietnike" e të ngjashme, që Shkupit i

---

<sup>2061</sup> Shih Platformën politike të PPDSH-së të udhëhequr nga Arben Xhaferi, në maj 1995, te Rexhepi, Zeqirja "Partia Demokratike Shqiptare", Tetovë, 2004, faqe 109.

<sup>2062</sup> Shih letrën e hapur të Nevzat Halimit pas ndarjes së PPD-së dhe largimit të tij prej saj, "Quo vadis, Shqipëri?", te "Flaka e vëllazërimit", 18 shkurt 1994.

shkonin për shtati të ruante “paqen e brendshme” e të ngjashme, formulë kjo që po ashtu mund të thuhej se në ato rrethana u shkonte për shtati thuajse të gjithëve: maqedonasve, Kosovës dhe Shqipërisë, siç i shkonte për shtati edhe faktorit ndërkombëtar (Pe-rëndimit), i cili kërkonte që kriza që kishte shpërthyer nga politika hegjemoniste e Beogradit, të mbahej në mbikëqyrje, por njëherësh që asaj t’i jepej epilogo në përputhje me interesat perëndimore.

## RAPORTET MIDIS MAQEDONISË DHE KOSOVËS NË PRAK TË LUTËS NË KOSOVË

Nëse mund të thuhet se qëndrimi i Maqedonisë ndaj çështjes shqiptare në përgjithësi si dhe Kosovës në veçanti, nga krijimi i Jugosllavisë së AVNOJ-it, në përputhje me oscilimet e Titos ndaj saj, kanë qenë identike me ato të Beogradit, dhe se, në vitet 1981-1991, Shkupi zyrtar u rreshtua në kursin antishqiptar të Serbisë për rrënimin e pozitës kushtetuese të Kosovës në federatën jugosllave ku ajo me kushtetutën e vitit 1974 u ngrit në pozitën e faktorit të barabartë, nga viti 1991 e këndeje, pra nga shpallja e pavarësisë, Maqedonia shqiptarët i trajtoi si pakicë kombëtare, ndërsa Kosovën si “krahinë” të Serbisë. Kjo flet për një qëndrim antihistorik të këtij shteti ndaj çështjes.

Këtë qëndrim Maqedonia mbajti jo vetëm në rrethanat kur Serbia, ripushtoi Kosovën, ndërsa shqiptarët e Kosovës, me Deklaratën Kushtetuese të 2 korrikut 1990 dhe Kuvendin e Kaçanikut të 7 shtatorit 1990 me shpalljen e Republikës së Kosovës, u shkëputën nga Beogradi, por do ta mbajë edhe në vitet në vijim, kur politika hegjemoniste e Serbisë do të kthehet në politikë lufte në Kroaci dhe Bosnje dhe Hercegovinë me pasoja tragjike. Thuajse në të gjitha prononcimet, presidenti maqedonas Kiro Gligorov Kosovën e trajtonte “pjesë” të Serbisë, duke vu theksin te “respektimi i të drejtave njerëzore” në përputhje me “standartet e pakicave” dhe jo te një etnie, e cila në federatën jugosllave kishte pozitë të barabartë, e drejtë kjo që i ishte shkelur dhunshëm nga Beogradi.<sup>2063</sup>

Edhe pse qëndrimi i Gligorovit në këtë aspekt nuk ndryshonte nga ai i bashkësisë ndërkombëtare, megjithatë, anashkalimi i realiteteve politike që kishin krijuar shqiptarët e Kosovës me organizimin e tyre të “shtetit paralel” si dhe legjitimitetin demokratik që e kishte, e mbi të gjitha, përfshirja e shqiptarëve në shtetin

---

<sup>2063</sup> Глигоров, Кири: „Македонија е све што имаме“, Shkur, 2002.

maqedonas, e obligonte atë për realizëm politik, që Gligorovi duhej ta kishte parasysh, sidomos qëndrimin e Kosovës në përkrahje të pavarësisë së Maqedonisë, me ç'rast, lideri i "Lidhjes Demokratike të Kosovës", forcës kryesore të lëvizjes kombëtare, dr. Ibrahim Rugova, kishte kërkuar nga faktori politik shqiptar në Maqedoni që të mbështetnin shtetin e pavarur të Maqedonisë me kusht që t'u garantohej pozita e barabartë. Këtë qëndrim, dr. Rugova e kishte ripërsëritur edhe pas zgjedhjes President i Republikës së Kosovës në prill 1992. Krahas kësaj, nga shqiptarët në Maqedoni, presidenti Rugova, kishte kërkuar të mos përfshihen në kurrfarë zhvillimesh, nga ato nën plaf dhe haptas, që mund ta rrezikonin ekzistencën e shtetit maqedonas, meqë vlerësohej se një Maqedoni e pavarur, pa marrë parasysh përcaktimet koniunktureale me Beogradin dhe të tjerat, ishte në interes të shqiptarëve dhe çështjes së tyre.

Theksimi i kësaj çështje ka rëndësi për vetë ekzistencën e shtetit maqedonas, ngaqë, Beogradi, përkundër mbështetjes që ia jepte Shkupit që shqiptarët t'i mbante të diskriminuar me statusin e pakicës, disa herë, në forma të ndryshme, nga Rugova kishte kërkuar që të përfshihej në disa pazarllëqe për copëtimin e Maqedonisë "në vija etnike", që si kusht kishte pjesëmarrjen e shqiptarëve në një kryengritje të kurdisur atje nga Beogradi, e cila do të mbështetej nga Kosova. Ofertën që i kishte ardhur nga Shesheli dhe radikalët e tij,<sup>2064</sup> si dhe atë nga Qosiqi pasi që të jetë zgjedhur Kryetar i Jugosllavisë, dr. Rugova e kishte refuzuar me arsyetimin se "nuk dëshironte të hynte në kurrfarë lojërash që do t'u shkonin për shtati skenarëve për Serbinë e Madhe", veçmas në Maqedoni, ku shqiptarët interesin e tyre e shihnin jo në copëtimin e saj, por në forcimin e shtetit të përbashkët, por si të barabartë dhe demokratik.<sup>2065</sup>

Se Rugova ishte parimor në këtë çështje, por edhe në përkushtimin e tij që pjesëmarrja e shqiptarëve në jetën parlamentare dhe atë institucionale të vendit të mos shndërrohej në farsë, siç do të ndodhë në të vërtetë nga viti 1994-2001, por që ajo të kushtëzohet me kërkesën e shqiptarëve për barazi të plotë (statusi i popullit shtetformues), këtë qëndrim do t'ia kërkojë edhe Arbën Xhaferit, pasi që ai të marrë drejtimin e PPDSH-së dhe do të kthehet në lider politik të shqiptarëve në Maqedoni me çmimin e shkëputjes nga PPD të Nevzat Haliliti dhe me koston e dobësimit të faktorit politik shqiptar në Maqedoni në përputhje me qëndrimin e

---

<sup>2064</sup> Buxhovi, Jusuf: "Kosova" I-V, Prishtinë, 2015, libri V, faqe 364-371.

<sup>2065</sup> Po aty.

Shkupit, që skena politike shqiptare të jetë sa më e shkapërderdhur dhe e përcarë.<sup>2066</sup>

Natyrisht se ky qëndrim do të ndikojë që politika zyrtare maqedonase “të jetë skeptike” ndaj “gatishmërisë” së Rugovës për ta mbështetur pavarësinë e Maqedonisë, duke e shikuar atë si “çështje koniunkturale”. Kjo madje do të bëjë që politika zyrtare maqedonase të veprojë me të gjitha prapaskenat e mundshme kundër “Partisë së Prosperitetit Demokratik” të drejtuar nga N. Halili, në mënyrë që ajo të përçahej, ngaqë konsiderohej “dorë e fshehur” e Rugovës në Maqedoni, edhe pse kjo parti ishte themeluar nën mbikëqyrjen dhe ndikimin e drejtpërdrejt të LDK-së dhe Rugovës në rrethanat e fillimit të krizës së ish Jugosllavisë kur faktori politik shqiptar, i lidhur me atë të Kosovës, shfaqej si strumbullar i lëvizjes politike shqiptare që asaj t’i jepej përgjigjja në përputhje me interesat shqiptare gjithnjë duke pasur parasysh zhvillimet dhe rrethanat. “Partia e Prosperitetit Demokratik” si anëtare e barabartë e Këshillit të Partive Politike Shqiptare në Jugosllavi, kishte përkrahur platformën e dalë prej saj prej tri opsionesh, ku shqiptarët, sipas opsionit të parë, në rast se ruhej konstalacioni i një federate të barabartë, e ku ruhej edhe Republika e Maqedonisë, përkrahnin Republikën e Kosovës. Sipas opsionit të dytë, po qe do të rrënoheshin raportet e brendshme jugosllave prej tetë njësive, shqiptarët e Maqedonisë përkrahnin, republikën e përbashkët shqiptare në Jugosllavi. Ndërsa sipas opsionit të tretë – po qe se Jugosllavia shpërbëhej në tërësi, shfaqeshin me opsionin e bashkimit kombëtar.<sup>2067</sup>

Largimi i N. Halilit nga jeta politike si dhe burgosja e tij “për veprimtari armiqësore”, ndonëse e gjitha lidhej me projektin e “Iliridës” dhe pikëpamjet e tij por edhe te një pjese të madhe të faktorit shqiptar atje rreth lidhjeve të pashkëputshme Kosovë-Maqedoni si dhe mbajtjes së tyre në të gjitha rrethanat, me katapultimin e Arben Xhaferit në skenën politike të Maqedonisë si lider i partisë më të madhe shqiptare, solli opsionin e Maqedonisë “shtet demokratik multi-etnik”, si një kompromis midis *shtetit-kombëtar*, siç ishte ndërtuar Maqedonia me kushtetutën e vitit 1992, dhe “të drejtave demokratike të standardeve perëndimore”, ku zbatimi i tyre në përputhje me standardet më të larta legjitimonte barazinë për të gjithë, me çka, sipas Xhaferit, edhe shqiptarët barazoheshin me të

---

<sup>2066</sup> Nga letërkëmbimi i autorit me Dr. Rugovën në vitin 2002-2005.

<sup>2067</sup> Buxhovi, Jusuf: “Kosova” I-V, Prishtinë, 2015, libri V, faqe, 246-250.

tjerët, në kuadër të një kushtetute demokratike, ku shqiptarët patjetër duhet të trajtohen si bashkësi e barabartë në Maqedoni.<sup>2068</sup>

Opsioni i “shtetit demokratik”, në të cilin shqiptarët “duhet të trajtohen si bashkësi e barabartë”, me çka nuk rrezikohej fare koncepti *shtet-komb*, mbi të cilin ishte ndërtuar Maqedonia dhe, Gligorovi, edhe para foltores së OKB-së më 26 prill 1993 do ta quajë “të arritur historike dhe demokratike të qytetarëve të Maqedonisë”,<sup>2069</sup> i krijoi Maqedonisë imazhin e “një oaze” evropiane në hapësirën e trazuar me plot luftëra të ish Jugosllavisë, me çka ajo filloi të përkrahet me të madhe dhe të kthehet në një shëmbëllesë madje.

Por, Gligorovi, një politikan i rryer, që e dinte se çfarë ziente kazani i brendshëm maqedonas dhe si mund të shpërthente një ditë, veçmas pas marrëveshjeve të Dejtonit, kur Millosheviqi praktikisht pranoi disfatën e “Serbosllavisë” dhe çështja e Kosovës, për faktin se doemos do të vihej në rend të ditës “si e veçantë”, në përputhje me interesat perëndimore, do të përpiqet që ta ndryshojë retorikën, duke nxjerrë ndonjë fjalë rreth “shkeljes së të drejtave të shqiptarëve në Kosovë” si dhe “nevojës që çështja të zgjidhet me mjete paqësore dhe dialog”, por gjithnjë duke aluduar se Kosova duhej të mbetej në kuadër të Beogradit.

Në kuadër të kësaj retorike, që përfitonte më së shumti, Shkupi zyrtar filloi të tregojë paksa “më fleksibil” (në të vërtetë i frikësuar) edhe pas shfaqjes së rezistencës së armatosur në Kosovë, nga mesi i vitit të ardhshëm dhe, sidomos, nga fundi i vitit 1997 kur “Ushtria Çlirimtare e Kosovës” doli publikisht dhe mori përsipër drejtimin e rezistencës armatosur, me çka lëvizja institucionale paqësore e Rugovës sikur tejkalohet.

Kthimi i politikës maqedonase kah “realiteti”, kishte të bënte me atë se politikës hegjemoniste të Beogradit, me të cilën ajo, për vite të tëra, kishte koketuar, sidomos në raport me shqiptarët, po i vinte fundi. Nga frika se lufta si vazhdim i politikës me mjete të tjera mund ta prekte edhe Maqedoni e me këtë edhe statusin e saj në raport me shqiptarët, që nuk mund t’ia garantonte më Beogradi, Shkupi zyrtar kishte pranuar thujtë gjithë infrastrukturën “vëzhguese” të OSBE-së në Maqedoni, siç kishte pranuar edhe misionet e tjera vëzhguese humanitare nga disa vende perëndimore (Gjermania), qëllimi i të cilave ishte jo vetëm “monitorimi” i gjendjes siç thuhej, por edhe marrja e masave për parandalimin e shtrirjes së konfliktit në Maqedoni.

---

<sup>2068</sup> Shih “Platforma e PDSH-së”, te Rexhepi, Zeqirja: “Partia Demokratike Shqiptare”, Tetovë, 2004, faqe 131.

<sup>2069</sup> Глигоров, Киро: „Македонија е се што имаме“, Shkup, 2002, faqe 345.

Dhe, duke parë zhvillimet në Kosovë që po merrnin kahun e konflikteve të armatosura, në fillim të vitit 1997, Maqedonia kishte kërkuar vëzhgues nga OKB-ja, OSBE-ja, duke përfshirë edhe ushtarakë, me çka haptas po largohej nga “ombrella” e pushpallur mbrojtëse e Beogradit. Kështu, në mesin e vitit 1997, Qeveria e Maqedonisë kishte lidhë një marrëveshje me Qeverinë Gjermane për dërgimin e vëzhguesve civil dhe ushtarak në Maqedoni, që do të monitoronin krizën në tre-kufirin midis Shqipërisë, Maqedonisë dhe Kosovës.<sup>2070</sup>

Në të njëjtën kohë, ishin lidhur marrëveshje të ngjashme edhe me SHBA-në dhe disa misione të tjera ndërkombëtare të natyrës humanitare.<sup>2071</sup>

Ashpërsimi i krizës në Kosovë pas plasjes së konflikteve të armatosura në pranverën e vitit 1998, kur “Ushtria Çlirimtare e Kosovës” tashmë në shumë pjesë të vendit kishte krijuar edhe “zona të lira”, e detyruan Maqedoni që thuajse në tërësi të mbështetet te OSBE-ja, OKB-ja, po edhe NATO-ja. Faktikisht, Maqedonia mori garancione nga SHBA-ja, po edhe NATO-ja dhe partnerët tjerë evropianë, se nuk do të lejohet zgjerimi i krizës në Maqedoni as nga ana e Serbisë, as nga ana e Kosovës e as nga Shqipëria. Këto “garancione” kishin për çmim vënien në dispozicion të Maqedonisë dhe hapësirës së saj të gjithëmbarshtëmepër qëllime humanitare (pranimin e refugjatëve, strehimin e tyre të përkohshëm si dhe krijimin e kushteve për organizatat humanitare dhe misionet tjera që lidheshin me to).<sup>2072</sup>

Mund të thuhet se nga mesi i vitit 1989 e deri në qershorin e vitit 1999, Maqedonia si dhe Shqipëria, detyrimisht u kthyen në poligon të infrastrukturës humanitare, po edhe të logjistikës ushtarake të NATO-s. Kjo u pasqyrua, veçmas me rastin e fillimit të fushatës ajrore të NATO-s nga 24 marsi deri më 12 qershor 1999, kur Aleanca Veriperëndimore bombardoi caqet ushtarake të armatës jugosllave dhe të policisë serbe në Kosovë dhe në Serbi. Madje, jo rastësisht, edhe marrëveshja ushtarake midis gjeneralëve të NATO-s dhe atyre të armatës jugosllave, e 9 qershorit për tërheqjen e forcave ushtarake dhe policore jugosllave nga Kosova, u nënshkrua në Kumanovë.

Nga fillimi i prillit deri në qershor, Maqedonia pranoi mbi 500 mijë refugjatë shqiptarë nga Kosova. Fillimisht, Maqedonia deshi të parandalojë fluksin e madh të refugjatëve që hynin në drejtim të Tetovës dhe të Shkupit, gjë që do t'i shkonte

---

<sup>2070</sup> Laquoi, Heinz: “*Der Kosovo-Konflikt – Wege in einen vermeidbaren Krieg*”, Baden-Baden, 2000.

<sup>2071</sup> Lutz, S. Dieter: “*Der Kosovo-Krieg*”, Baden-Baden, 2000; Schmid, Thomas: “*Krieg im Kosovo*”, Hamburg, 1999.

<sup>2072</sup> Biermann, Rafael: “*Leherjahre im Kosovo*”, Bonn, 2002, faqe 580-586.

përdore Millosheviqit që lëvizjen e popullatës brenda Kosovës ta shfrytëzojë si strategji për uljen e intensitetit të bombardimeve të NATO-s nga shkak i mbrojtjes së civilëve të kthyer në caqe ushtarake. Kjo përpjekje u pasqyrua me kampin kalimtarë në Bllacë, kur nga 2 deri më 6 prill, dhjetëra mijëra refugjatë, u ngjuan në një hapësirë të improvizuar aty, në kushtet të vështira humanitare. Kjo detyroi OKB-në dhe mekanizmat tjerë humanitarë që kampi i Bllacës të zbrazel, ndërsa kalimi për në Maqedoni të mbetej i hapur për refugjatë. Mijëra refugjatë u bartën në dy qendra të tjera të pranimit (kampe) në Stankovc afër Shkupit dhe në një tjetër në drejtim të Tetovës. Nga aty, një pjesë e refugjatëve u transportuan në vendet europiane, në SHBA, Kanada dhe Australi.

Kalimi i refugjatëve në Maqedoni, mbi gjysmë milioni sosh, si dhe vendosja e tyre e përkohshme në disa kampe, paraqet një kapitull të rëndësishëm të ndihmës humanitare që Maqedonia ia dha Kosovës në rrethanat tepër tragjike nëpër të cilat po kalonte popullata e gjithëmbarshme e saj.

Kësaj gjithësesi i dha krah solidariteti i madh i popullatës shqiptare në brezin kufitar, nga Tetova deri në Shkup dhe Kumanovë dhe gatishmëria e tyre që të vejnë çdo gjë në dispozicion të tyre, pa përjashtuar edhe pjesëmarrjen në luftë të shumë të rinjve, të cilët dhanë edhe jetën.

## RAPORTET MIDIS MAQEDONISË E SHQIPËRISË

Krahas raporteve me Kosovën, që kaluan nëpër disa faza thuajse dramatike, nga të cilat Maqedonia, ndonëse aleate e Beogradit, për arsye strategjike dhe politike të rrethanave, gëzoi përkrahjen e faktorit politik shqiptar në procesin e pavarësimit si dhe siguroi “paqen e brendshme” disavjeçare edhe në dëm të shqiptarëve duke i degraduar në pakicë kombëtare, ato me Shqipërinë, po ashtu ishin të një rëndësie të veçantë për Shkupin dhe kursin e konstituimit si shtet i pavarur në rrethanat kur ajo ndodhej në udhëkryq të krizës rajonale. Në këtë aspekt, politika maqedonase jo vetëm që mori përkrahjen e politikës shqiptare në të gjitha fazat në planin politik dhe atë diplomatik, por ajo u mbështet edhe në forumet ndërkombëtare (OKB, OSBE e të tjera), ku Shqipëria kishte zërin e vet dhe mund ta kontestonte konceptin *shtet-komb* mbi të cilin Maqedonia shpalli pavarësinë duke i diskriminuar shqiptarët.

Heshtja e Shqipërisë karshi këtij fakti si dhe përkrahja ndërkombëtare që iu dha shtetit maqedonas, kishte arsytet e veta, të brendshme dhe të jashtme, ku

ato të brendshmet (vështirësitë gjatë tranzicionit si dhe shfaqja e kaosit në gjysmën e dytë të viteve të nëntëdhjeta me ngjarjet e përgjakshme të viti 1997), luajnë një rol të veçantë.

Duhet thënë se kundruall këtyre rrethanave Shkupi zyrtar sillet me mjaft komoditet në raport me Shqipërinë. Kjo madje, do të ndikojë edhe sjellje e mëtutjeshme vasale ndaj Beogradit në raport me Beogradin dhe në përgjithësi me çështjen shqiptare, ngaqë politika maqedonase nuk sfidohej me asgjë që të vepronte ndryshe. Përkundrazi, Maqedonia, në disa raste, hapi edhe çështjen e të drejtave të “pakicës maqedonase” në Shqipëri, me ç’rast, ia doli që Tirana zyrtare të konfirmojë edhe ekzistencën e saj në disa pjesë në saje të deklaramit të ndonjë individi ose grupi të kufizuar gjuhësor. Në këtë aspekt, Shqipëria pranoi që shqiptarët në Maqedoni, ndonëse etni historike dhe kulturore, të trajtohen me statusin e pakicës, duke kërkuar që në përputhje me të t’u garantohen të drejtat dhe liritë njerëzore.

Edhe përkundër kësaj gjendjeje politike, mund të thuhet se nga krijimi i Maqedonisë si shtet i pavarur, midis Shkupit dhe Tiranës, marrëdhëniet ekonomike dhe ato të qarkullimit të lirë të mallrave dhe të qytetarëve shënuan një ngritje pozitive me përfitime të dyanshme. Ngjashëm do të jetë edhe me shkëmbimet kulturore dhe ato arsimore pa ndalesat dhe kufizimet që kishin gjatë kufirit ideologjik.

Por, ajo që bie në sy nga mesi i viteve të nëntëdhjeta e këndeje, ka të bëjë me interesimin e Tiranës zyrtare për ndikim politik tek subjektet politike shqiptare në Maqedoni si dhe tek spektri intelektual, tradicionalisht i lidhur me Kosovën.

Meqë, historikisht, nga antikiteti po edhe në të gjitha zhvillimet deri në ato më të reja që kishin përcaktuar edhe shtetndërtimin shqiptar, shqiptarët e Maqedonisë kishin qenë të lidhur vazhdimisht me Kosovën dhe fatin e saj në të gjitha aspektet (shoqërore, shpirtërore dhe politike), ishte e natyrshme që kjo lidhje edhe më tutje të zgjerohej edhe me ato në drejtim të Shqipërisë, kur kufiri ideologjik ndërshqiptar kishte rënë, ndërkohë që shteti maqedonas shfaqej si një faktor i ri në këtë mes.

Ky zhvillim, megjithatë, do nxjerr në pah përpjekjet e Shkupit zyrtar, pra të politikës maqedonase, në njërën anë që raportet me Kosovën të mbahen të “limituara” në përputhje me realitetet e reja shtetërore dhe në tjetrën anë, që raportet me Shqipërinë të orientohen në atë mënyrë që ndikimi i Shqipërisë të rruhdë apo të eliminojë fare lidhjet shpirtërore dhe kulturore të Kosovës me Maqedoninë, të cilat janë parë përherë të rrezikshme.



Mund të thuhet se mbi këtë planimetri të Shkupit do të fillojnë të sillen si Shqipëria si dhe subjektet politike shqiptare në Maqedoni, veçmas pas ardhjes në krye të PPDSH-së më vonë të PDSH-së të Arben Xhaferit, me ç'rast, ai do të kthehet në fokus të interesimit të politikës shqiptare, po edhe të Shkupit, drejt një faktorizimi, që nënkuptonte në njëfarë mënyre shkëputjen nga lidhja me Kosovën, veçmas nga ndikimi i Rugovës dhe lidhjen me Shqipërinë, në rastin konkret me Sali Berishën asokohe në pushtet.

Natyrisht se edhe për Arben Xhaferin, “roli i ri” në raport me Shkupin po edhe Tiranën, shfaqej tepër joshës, ngaqë e nxirrte nga anonimiteti i Prishtinës, drejt një “orbitri”, ku ai, me formulat e “standardeve demokratike” dhe “shoqëri-në multietnike” me të cilat operonte shumë mirë, shfaqej me “recetën pajtuese” midis opsionit “shtet-komb”, mbi të cilin ishte ndërtuar Maqedonia dhe atij “të shoqërisë demokratike”, në përputhje me kërkesat evropiane dhe kriteret e tyre për përballimin “e trazicioneve pa konflikte” e të ngjashme.

Në këtë rol, Arben Xhaferi, të cilit nuk mund t'i mohohet kultura politike dhe intelektualizmi i niveleve jugosllave, shfaqej i dobishëm për politikën maqedonase, por edhe për politikën shqiptare të Tiranës (atë që drejtonte S. Berisha), që kishte syrin nga Maqedonia dhe lidhja e faktorit të atjeshëm politik shqiptar me Shqipërinë.

Me siguri se faktorizimi i A. Xhaferit nga ana e Shqipërisë, po qe se ai do të përcaktohej për avancimin e statusit të shqiptarëve në Maqedoni në atë të popullit shtetndërtues dhe jo në të pakicës në të cilën gjendej, do të ishte i dobishëm, me kusht që të mos ndikoheshin lidhjet historike dhe kulturore të shqiptarëve me Kosovën, paçka se Maqedonia ishte shpallur shtet i pavarur, ndërsa Kosova ndodhej në një gjendje kur po luftonte me të gjitha mjetet për t'u liruar nga pushtimi serb.

Bie në sy se lidhja e A. Xhaferit me Tiranën zyrtare nuk i la të pandikuar lidhjet me Kosovën, për ç'gjë ishte tepër e interesuar edhe politika maqedonase, e cila, në mënyrë aktive, kishte vepruar që të përçajë faktorin e atjeshëm politik, sidomos “Partinë e Prosperitetit Demokratik” – bijë e “Lidhjes Demokratike të Kosovës”, siç do të ndodhë në të vërtetë në vitin 1994. Madje, me kycjen e A. Demaçit në këtë projekt, politika e atëhershme shqiptare, në njërën anë kërkonte që shqiptarët e Kosovës të merrnin pjesë në zgjedhjet serbe për “t'i dhënë krah ndryshimeve demokratike në Serbi”, dhe në tjetrën anë, kërkonte që politikës së rezistencës institucionale të Rugovës (shtetit paralel) t'i krijohet me çdo kusht “alternativa e rezistencës aktive” deri në luftë, jashtë rrethanave të

përshtatshme për të, edhe pse A. Xhaferi bënte çmos që lufta ta kursente Maqedoninë. Do të shihet, se kursi “radikal” i Tiranës zyrtare ishte që, me hapjen e ndonjë konflikti të parakohshëm në Kosovë dhe jashtë bashkëpunimit me amerikanët, të shpëtohej politika e kolapsit e shtetit shqiptar e krijuar nga sistemi piramidave, korrupsioni, kriminaliteti dhe të tjerave, siç ndodhi në të vërtetë në marsin e vitit 1997, kur Shqipëria u zhyt në një luftë qytetare dhe ndodhej buzë shkatërrimit si shtet.

Kapitulli i kolapsit tragjik të shtetit shqiptar në vitin 1997, shpërthimi i luftës qytetare me disa mijëra viktima si dhe ato që ndodhën më pas deri te ndërhyrja e NATO-s për çlirimin e Kosovës në pranverën-verën e vitit 1999, i shkuan për shtati shtetit maqedonas që të ruajë kursin e vitit 1991, të mbështetur mbi konceptin shtet-komb. Ndërrimi i kursit politik në Shqipëri (rënia e Berishës dhe ardhja e socialistëve të Nanos), ndonëse në rrethanat kur ndërhyrja ndërkombëtare në Kosovë po përgatitej dhe ndodhej në binarët “e formaliteteve”, nuk ndryshoi raportet midis Maqedonisë dhe Shqipërisë ndaj faktorit politik shqiptar në Maqedoni dhe rolit të tyre që lidhja historike me Kosovën të zëvendësohet me atë me Shqipërinë, qoftë edhe në emër të “bashkimit kombëtar”. Në këtë riorientim, edhe Arben Xhaferi ruajti pozitat që kishte gjatë kohës së Sali Berishës, duke i forcuar edhe më shumë me faktorin “e luftës” në Kosovë, kryesisht nga radhët e LPK-së – aleates së ngushtë të neokomunistëve shqiptarë, që do të marrin përsipër “patronatin” mbi UÇK-në dhe rezistencën e armatosur.

Pykat që do të futen midis lëvizjes së rezistencës institucionale të Rugovës dhe UÇK-së në dëm të rezistencës së përbashkët të armatosur të drejtuar institucionalisht, në të cilat qoftë edhe me qëllime pragmatike ishte i përfshirë edhe Arben Xhaferi, Maqedonisë do t’i shkojnë për shtati, meqë energjia e faktorit politik shqiptar, i përfshirë në bashkëqeverisje me atë maqedonas por në rolin e vasalit, do të fokusohet gjetiu dhe jo te kërkesa për statusin e popullit të barabartë shtetformues si dhe eliminimi i gjendjes së diskriminimit “demokratik”, për ç’gjë do të çojë edhe te lufta e vitit 2001.

## KAPITULLI I PESTË

### MAQEDONIA DHE LUFTA E “USHTRISË ÇLIRIMTARE KOMBËTARE” E VITIT 2001

#### LUFTA PËR PAQJEN E PAPËRFUNDUAR

Mbyllja e konfliktit të armatosur në Luginën e Preshevës gjatë vitit 2000 midis UÇPMB-së dhe forcave policore serbe dhe atyre të armatës jugosllave të stacionuar në atë pjesë si dhe epilogu i pakënaqshëm për shqiptarët e atjeshëm, të cilët kishin pritur, që së pakut, faktori ndërkombëtar të hapte çështjen e një autonomie politike dhe territoriale në përputhje me kërkesat që kishin dalë nga referendumi i marsit të viti 1992, hapi një luftë tjetër të shqiptarëve në afërsi të frontit të pakmëparshëm, në një hapësirë gjeografike, ku një kufi ndante në tre shtete shqiptarët etnikë (Kosovë, Serbi dhe Maqedoni), të cilët, në kohën e ish Jugosllavisë, kishin jetuar në një shtet të përbashkët, ndonëse të ndarë në njësi të ndryshme administrative, të cilat nuk kishin penguar zhvillimin e përbashkët arsimor, kulturor në kuadër të konceptit ideologjik të barazisë së kombeve dhe kombësive si dhe standardët që ishin ngritur mbi to në gjithë vendin. Në atë shtet të përbashkët, pra në Jugosllavinë e Titos, me gjithë që shqiptarët e shpërndarë në tri njësi administrative (në republikën e Maqedonisë, në Krahinën Socialiste të Kosovës dhe në Luginën e Preshevës në tri komuna), si pjesë e të njëjtës etni, Kosovën e shihnin si një qendër kulturore, arsimore dhe shpirtërore, gjë që ishte edhe arsyeshme që për shqiptarët e Maqedonisë dhe ata të Luginës së Preshevës, ngritja e statusit politik të Kosovës drejt avancimit me kushtetutën e vitit 1974, të merrej edhe si fitore e tyre.

Kthimi te gjendja e kërkesave të viteve të gjashtëdhjeta dhe të atyre të tetëdhjeta, brenda realiteteve të atëhershme jugosllave të kufijve administrativë, që nuk pengonin identitetin e përbashkët kombëtar, por përkundrazi, në zhvillimet e fundit pas ndryshimeve që solli Plenumi i Brionëve i vitit 1996, atë e ndihmonin, si dhe te realitetet e reja që solli shpërbërja e ish Jugosllavisë e me këtë edhe luftën në hapësirën shqiptare, në Kosovë, Luginë të Preshevës dhe Maqedoni

(1997-2001), ka të bëjë me rikthimin e të drejtës për një pozicionim politik, që duhej të shfrytëzohej në rrethanat e reja gjeostrategjike të rikthimit të Perëndimit në pjesën më të madhe të Ballkanit, edhe me futjen në lojë të faktorit luftë. Meqë lufta kishte përcaktuar edhe fatin e ndarjeve, po edhe të tragjediave shqiptare në këto hapësira, veçmas nga shembja e Perandorisë Osmane e këndeje, kur nacionalizmat hegjemoniste të fqinjëve (serbëve, malaziasve, grekëve dhe bullgarëve) kishin konfiguruar hartën politike dhe shtetërore të gadishullit ilirik, të shumtën në dëm të shqiptarëve, siç ishte Jugosllavia e Versajës, që megjithatë nuk i kishte bërë ballë testit të kohës edhe nga shkaku se nuk kishte qenë në gjendje ta shuajë me dhunë problemin shqiptar në të, siç pretendonin hegjemonistët nga të gjitha anët, por as ta durojë barazinë e shqiptarëve me të tjerët, në një shtet të përbashkët, siç proklamonin komunistët gjatë dhe pas luftës. Rrënimi i Jugosllavisë, shqiptarëve nuk do t'ua kthejë gjendjen që kishin kur etnia e tyre përbashkët historike u copëtua dhunshëm. Megjithatë, vënia e Kosovës nën protektorat ndërkombëtar, me çka merr fund pushtimi gati një shekullor serb dhe, shpallja e Maqedonisë shtet i pavarur, me kusht që shqiptarët të luftojnë për një pozicion sa më të përshtatshëm politik, që do t'ua siguronte statusi i popullit shtetndërtues, krijuan mundësitë për rikthimin e një politike, ndonëse me interesa “parciale”, në përputhje me shtrirjen e tyre etnike.

Andaj, kundrimi i konflikteve të armatosura në Maqedoni si dhe zhvillimet e atjeshme që sollën ato, pa marrë parasysh se nga ç'pozicione u shfaqen ato dhe cilat ishin forcat që u vunë në krye të tyre, flasin për një përpjekje të papërfunduar të këtij qëllimi historik, jo rastësisht të lidhur me Kosovën, si epiqendër ku shqiptarizmi i kthyer në një program politik në Kuvendin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në qershor 1878, drejtoi lëvizjen kombëtare për pavarësi, në konfigurimin e së cilës, megjithatë hapësira e Maqedonisë së tanishme, në masë të madhe në përbërje të Vilajetit të Kosovës (me Shkupin si kryeqendër), ua përcaktoi epilogun këtyre zhvillimeve, siç ishte ai i gushtit të vitit 1912, kur kryengritja e madhe e asaj vere, përfundoi me marrëveshjen e njohur si Katërmbëdhjetë pikshi i Hasan Prishtinës, me ç'rast Perandoria Osmane pranoi atë që mund të quhet Shqipëri Osmane (etninë e bashkuar shqiptare në katër vilajete: të Kosovës, Shkodrës, Manastirit dhe të Janinës). Kjo fitore e madhe e nacionalizmit shqiptar, ia hapi rrugën shtetit të pavarur shqiptar, të shpallur më 28 nëntor 1912 në Vlorë, paçka se Kosova dhe Maqedonia si dhe pjesë të tjera të etnisë shqiptare që me dije dhe gjak e kishin përgatitur atë, si pasojë e luftërave ballkanike dhe pushtimit të hapësirës së tyre nga ushtritë serbe, malaziase, bullgare dhe greke, mbetën të

shkëputura jashtë trungut shqiptar, nën robërinë serbe, malaziasë dhe greke, gjendje kjo që qendrën historike dhe shpirtërore shqiptare e ktheu në periferi, ndërsa periferinë (shtetin e cinguar shqiptar) në qendër, realitet ky që do të mund të kthehej në fatalitet historik, po qe se shqiptarët etnik në Kosovë dhe Maqedoni do të pajtoheshin me robërinë dhe me statusin “e pakicës” siç ua përcaktoi Konferenca e Ambasadorëve e Londrës e vitit 1913, ajo e Paqes e Parisit e vitit 1920, vendimet e Jaltës dhe të tjerat.

Ky kundrim historik, luftën në Maqedoni, në vitin 2001, dhjetë vjet pasi që Maqedonia e AVNOJ-it<sup>2073</sup> të shpallte pavarësinë nga federata jugosllave,<sup>2074</sup> edhe pas përmbylljes së saj me Marrëveshjen e Ohrit, të gushtit të atij viti, nuk e kthen në një episod të thjeshtë, “si një veprim që ishte i domosdoshme për t’i vu në tavolinën e gjelbër kërkesat e nëpërkëmbura për barazi”,<sup>2075</sup> por e rendit në kuadër të tri luftërave, që zhvilluan shqiptarët etnik të kësaj pjese brenda një shekulli për interesa kombëtare. Lufta e parë, ishte ajo e vitit 1912 kundër pushtimit serb. Lufta e dytë ishte ajo e vitit 1944-45 kundër pushtimeve sllavo-komuniste.

---

<sup>2073</sup> Konferenca e Dytë e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Jugosllavisë (Druga Sednica Jugoslovenskog Antifašističkog Vjeća), e njohur si AVNOJ, e mbajtur më 29 nëntor 1943 në Jajce (Bosnje), solli vendimin që Jugosllavia e ardhshme, e dalë nga lufta antifashiste, të riorganizohet në gjashtë njësi federative, të barabarta me të drejtën e shkëputjes. Ato ishin: Serbia, Kroacia, Sllovenia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Maqedonia. Vendimi që Maqedonia të shpallej njësi federative e Jugosllavisë, nuk kishte kurrfarë baze as formale, meqë në Jajce nuk kishte përfaqësues të Këshillave Nacionalçlirimtare dhe as nuk mund të kishte, ngaqë Maqedoni aso kohe ishte ndarë midis Bullgarisë (me pjesën e Pirinit dhe të Vardarit dhe Shkupin si kryeqendër), dhe Shqipërisë së Madhe (me Tetovën, Gostivarin dhe Dibërën), të krijuar nga Italia fashiste. Madje, edhe organizimi partiak i kësaj hapësire ishte i ndarë në dy pjesë: maqedonasit ishin të lidhur me Partinë Komuniste të Bullgarisë, ndërsa ato pak celula të komunistëve shqiptarë, nga viti 1943, ishin të lidhur me Partinë Komuniste të Jugosllavisë. E ashtuquajtura Parti Komuniste e Jugosllavisë për Maqedoninë, u themelua në Manastirin Prohorçinjski në afërsi të Kumanovës (në pjesën serbe), në të cilën u kooptuan formalisht dy-tre maqedonas që jetonin në Beograd (Kolishevski, Gligorov, Červenkovski e të tjerë), ndërkohë që ajo drejtohej nga serbi Svetozar Vukmanoviq – Tempo, përgjegjës për lidhjet midis komunistëve jugosllavë dhe atyre të Shqipërisë, që mbikëqyreshin drejtpërdrejt nga J. Broz Tito. Ndërsa Këshillat Antifashist Nacionalçlirimtarë (ASNOM), gjithnjë sipas direktivës së grupit komunist pa bazë partiake, u themeluan më 3 gusht 1944, pas kapitullimi të Bullgarisë fashiste, që u përcoll me futjen e aradheve partizane jugosllave dhe atyre bullgare. Në këto këshilla të dirigjuara nga partizanët jugosllavë, do të përfshihen edhe disa shqiptarë, të lidhur me komunistët jugosllavë dhe ata të Shqipërisë, që do të merren vesh për frontin e përbashkët antifashist, ku edhe u themeluan dy brigada të përbashkëta Maqedonase-shqiptare, që morën pjesë në luftimet kundër njësisive të rezistencës kombëtare në Luginën e Preshevës, të drejtuara nga kolonel F. Dibra, në Karadak dhe në Maqedoninë Perëndimore, të drejtuara nga Xhemë Gostivari.

<sup>2074</sup> Procesin e pavarësisimit si shtet, Maqedonia e nisi më Deklaratën që e aprovoi Kuvendi i Maqedonisë më 25 janar 1991. Në përputhje me këtë deklaratë, më 8 shtator 1991, u mbajt referendumi me pyetjen: “A jeni për Maqedoninë si shtet sovran me të drejtat që të hyhet në lidhjen e shteteve sovraane të Jugosllavisë”. Ky vendim ishte në përputhje me vendimet e Konferencës së Hagës, të gushtit 1991, me të cilat federata jugosllave shpallej në shpërbërje si dhe ato të Komisionit të Badinterit që mbikëqyrte këtë proces. Në referendium nuk morën pjesë shqiptarët etnikë, përbërja e të cilëve, në numrin e përgjithshëm të Maqedonisë sillej në rreth 30%, gjë që, nga këndvështrimi politik dhe ai demokratik, ky akt nuk kishte legjitimitet.

<sup>2075</sup> Rexhepi, Zeqirja: “Zhvillimet politiko-shoqërore të shqiptarët në Maqedoni 1990-2001”, Tetovë 2005.

Ndërsa, kjo e fundit, ndonëse e nisur si luftë çlirimtare-kombëtare, kishte për kërkesë arritjen e statusit të popullit shtetformues, pra atë të barazisë, me çka Maqedonia do të duhej të definohej edhe si shtet i shqiptarëve.

Kontekstet historike të dy luftërave të para (1912 dhe 1944-45) - kur mbrohej etnia nga pushtimet sllave si dhe lufta e fundit (2001) si luftë çlirimtare (me përqendrimin te arritja e statusit të popullit shtetformues),<sup>2076</sup> ndonëse dallojnë për nga objektivat politike në kuadër të konfigurimeve aktuale (shpërndarja në dy shtete dhe në një protektorat ndërkombëtar), megjithatë janë pjesë e zhvillimeve historike te një etnie me rrënjë në antikitet, që ka marrë pjesë në ndërtimin e qytetërime të vjetra si dhe perandorive dhe mbretërive më të njohura të botës: nga ajo e Trojës, e Dardanëve, të Maqedonisë e deri në atë të Romës e të Bizantit, që kërkon të trajtohet si etni autoktone historike dhe jo si pakicë, siç e përcaktonte kushtetuta e Maqedonisë, e vitit 1991.

Thadrimi i pakënaqësisë së shqiptarëve gjatë një decenie të jetës parlamentare nga refuzimi i Referendumit për autonomi-politike dhe territoriale të vitit 1992, e deri te shfaqja e krismave të Tanushës, të cila brenda një kohe të shkurtë u kthyen në një kryengritje të armatosur që përfshiu hapësirën drejt Tetovës, Gostivarit e deri në Dibër dhe së fundit u shfaq edhe në pjesën e Kumanovës dhe në periferinë e Shkupit me kërcënimin real që kryeqytetin ta vente nën rrethim dhe kështu ta shkëpuste nga pjesët tjera të vendit, lidhen edhe me luftën e Kosovës dhe kahun e saj. Andaj, kjo luftë nga shqiptarët në Maqedoni ishte përjetuar si e drejtë dhe si e pashmangshme, meqë, siç kishte ndodhë në Kosovë kur ajo u dha përgjigje gjithë atyre çështjeve që sjellja politike (lëvizja e rezistencës institucionale me shtetin paralel), ndonëse ua kishte krijuar kornizat e legjitimitetit, nuk kishte qenë në gjendje t'ua jepte, ngjashëm mund të ndihmonte edhe në Maqedoni, që shteti maqedon, pra maqedonasit, t'i pranojë shqiptarët të barabartë me statusin shtetformues, ose të rrezikojë që të shpërbehet, pra të shkatërrohet, me çka vetë Maqedonasit dilni humbësit më të mëdhenj.

Edhe pse bëhet fjalë për rrugë të ndryshme midis lëvizjes së rezistencës institucionale në Kosovë me shtetin paralel me atë të pjesëmarrjes së faktorit shqiptar në jetën institucionale të shtetit maqedonas, megjithatë ato si emërues të përbashkët kishin vullnetin politik për shtetin paralel në njërën anë dhe të pjesëmarrjes në shtetin e përbashkët në tjetrën si shtetformues, por ku lufta, si e imponuar, u ktheu në mjet të politikës për qëllime të caktuara.

---

<sup>2076</sup> Shih: Komunikatën nr. 6 të UÇK-së, te Ostreni, Gëzim: “*Ushtria Çlirimtare Kombëtare*”, Dibër, 2014.

Dhe, nëse mund të thuhet se Beogradi në vazhdimësi përdori dhunën deri te lufta për shkeljen e vullnetit demokratik të shqiptarëve që t'u imponohet pushtimi, në Maqedoni, politika maqedonase, duke parë se Kosova gjendej nën dhunën e Beogradit, ndërsa Shqipëria e përfshirë në kaos të vazhdueshëm assesi ta merrte veten dhe të kthehej në një faktor që mund të ndihmonte vëllezërit në Kosovë dhe Maqedoni dhe nga bindja se shqiptarët gjithandej ndodheshin në një orë të ligë, përdori “diktatin e demokracisë”, që shqiptarëve t'u imponohet tretmani i pakicës. Kështu, në rrethanat e parlamentarizmit, “shumica demokratike” (maqedonase) u përdor për diskriminimin e shqiptarëve dhe degradimin e tyre në pakicë me çka doli një e vërtetë se jo gjithnjë demokracia shfaqet si ilaç që zgjidh plagët e së kaluarës dhe padrejtësitë, veçmas kur kemi të bëjmë me vetëdije hegjemoniste dhe ngarkesat e tyre të rënda, siç ishin ato që vinin nga Beogradi dhe Shkupi në dëm të shqiptarëve dhe etnisë së tyre. Ashtu siç ndodhi në Serbi, në vitin 1989, kur Millosheviqi rrënoi me tanke autonominë e Kosovës, me arsyetimin se “rikthente të drejtën historike serbe” që “i ishte marrë në Kosovës”, ngjashëm veproi edhe Maqedonia “me të drejtën e shtetit kombëtar”, kur me aprovimin e Deklaratës së Pavarësisë në shtator 1991 dhe me Referendumin për pavarësi po në të njëjtin vit, “shumica” sllavo-maqedonase parlamentin e shfrytëzoi për të nxjerrë një kushtetutë për të shpallur *shtetin-kombëtar*, ku shqiptarët mund të përfshiheshin “si pakicë”, paçka se ata kishin të drejtën historike dhe atë etnike për shtetin nga antikiteti dhe në vazhdimësi.

Diskriminimi i shqiptarëve në Maqedoni me anën e “diktatit të demokracisë” dhe “të drejtës politike” për shtetin, qoftë si konstrukt artificial, thuajse ndiqte kahun paralel me ato të veprimeve të Beogradit kundër shqiptarëve të Kosovës nga viti 1991, kur Kosova me referendum shpalli pavarësinë dhe iu qas shtetit paralel e deri në vitin 1999, me ç'rast Serbia filloi fushatën policore dhe ushtarake për qërimin e hesapeve me mjetet e luftës që u parandalua nga ndërhyrja ushtarake e NATO-s, me çka mund të thuhet se midis Shkupit dhe Beogradit, jo vetëm që kishte pajtim rreth qëndrimit antishqiptar, por edhe veprime analoge politike, ku qoftë “demokracia”, qoftë lufta, të përdroreshin që ata të detyroheshin të mbeteshin me tretmanin e pakicave, paçka se ishte pikërisht ai trajtim dhe ajo politikë diskriminuese që Jugosllavinë e kishte shkatërruar.

Dhe, si do të shihet, do të jetë pikërisht lufta, së cilës një ditë do t'i kthehen edhe shqiptarët në Kosovë dhe në Maqedoni, që do t'ua përcaktojë epilogun këtyre dy zhvillimeve: Kosovën duke e nxjerrë nga okupimi serb dhe vendosur në një protektorat ndërkombëtar, me çka ajo vihej në binarët e pandalshëm të pava-

rësisë. Ndërsa, Maqedonisë do t'ia përmbysë realitetet kushtetuese (shtetin e një-anshëm kombëtar maqedonas me degradimin e shqiptarëve si pakicë), që ia kish-te krijuar “diktati i demokracisë”, me ç’rast, me Marrëveshjen e Ohrit, me krite-ret e barazisë brenda sistemi parlamentar, së paku formalisht, *shtetin-komb* e kthen në atë qytetar, paçka se ai me gjuhën zyrtare – maqedonishten me alfabet cirilik dhe simbolet tjera kombëtare, praktikisht ruan karakterin kombëtar maqedonas.

Shikuar në kuadër të këtij zhvillimi historik, lufta e shqiptarëve në Maqedoni, edhe pse mund të thuhet se paraqet një vazhdimësi të luftës së Kosovës, jo vetëm që në të morën pjesë një numër i madh i luftëtarëve në të dy këto luftëra dhe shumë prej tyre në to lanë edhe jetën (përfshirë këtu edhe strukturat kryesore komanduese të saj), por edhe pse është pjesë e luftës për interesa të përbashkëta kombëtare, megjithatë ka edhe veçoritë e veta të natyrës politike që atë e bëjnë autentike. Ndër to gjithsesi dallohen: organizimi, dinamika, kërkesat politike (për-caktimi për shtetin e Maqedonisë dhe lidhja e kërkesave për barazi kushtetuese në të), e mbi të gjitha, pasojat e saj, që kanë të bëjë me ndërhyrjen e faktorit ndërkombëtar në të (veçmas atij amerikan dhe evropian), që ajo të ndërpritej me anën e arritjes së një marrëveshje politike (të Ohrit), kur UÇK-ja shënonte suk-sese ushtarake ndaj ushtrisë maqedonase, që po të vazhdonin mund të sillnin edhe shembjen e shtetit të Maqedonisë, gjë kjo që do të hapte një krizë tjetër ra-jonale tepër të rrezikshme me shumë të panjohura.

Në këtë kundrim, aspektit *ushtarak*, gjithsesi është i rëndësishëm për t’u pa-raqitur, meqë bëhet fjalë për një luftë të organizuar mirë dhe shumë të sukses-shmenë planin ushtarak, që ia doli të ndërkombëtarizonte çështjen e shqiptarëve në Maqedoni si të pazgjidhur, veçmas në rrethanat kur nga jashtë Maqedonia kishte filluar të shihej “oazë paqeje”, me ç’rast i hapej rruga *platformës politike* të shqiptarëve rreth të ardhmes së Maqedonisë.

Si do të shihet, reagimi i faktorit ndërkombëtar (SHBA-ve, NATO-s, BE-së), ishte i shpejtë dhe energjik nga shkaku se Maqedonia jo vetëm nuk ishte në gjen-dje të fitonte luftën, por rrezikohej edhe ta humbte. Ndërhyrja e tyre jo vetëm që parandaloi që konflikti ushtarak të futej në një dinamikë të mëtutjeshme drejt ashpërsimit të krizës, por do t’ua përcaktojë kornizat politike kërkesave të shqip-tarëve, që u arritën në Prizren midis përfaqësuesve politikë dhe të UÇK-së, si dhe Marrëveshjes së Ohrit, midis shqiptarëve dhe shtetit maqedonas.

Por, ndërhyrja ndërkombëtare (veçmas ajo amerikane), krahas mbajtjes së konfliktit ushtarak nën mbikëqyrje deri te ndërprerja e tij e plotë, mund të thuhet ndikoi që edhe UÇK-ja të ndryshojë kërkesat me një shpejtësi të madhe: nga ato



të luftës çlirimtare me karakter kombëtar, siç i kishte në fillim, pas pak - në *luftë për pozitën e popullit shtetformues (shteti dy-kombesh)*, të cilat, shumë shpejt përfunduan të *çështja e barazisë* në kuadër të shtetit multi-etnik, epilog ky të cilit as që i duhej lufta.

## TRI ASPEKTET E LUFTËS SË UÇK-së: USHTARAK, DIPLOMATIKDHE POLITIKA

### *Aspekti ushtarak – lufta për territore*

Lufta në Maqedoni, edhe përkundër “paqes së rreme” që u krijua nga diskriminimi i hapur i shqiptarëve në jetën institucionale dhe politike i përcjellë me një histori nacionaliste në jetën publike, si dhe nga sjellja e papërgjegjshme shumë-vjeçare e faktorëve politikë shqiptar në jetën institucionale dhe politike të Maqedonisë, nuk ishte e pa pritshme kur shpërtheu, ngaqë paralajmërimet e saj vinin prej kohësh, veçmas pas përfundimit të luftës së Kosovës dhe realiteteve të njohura politike dhe shoqërore që krijoi ajo me protektoratin ndërkombëtar dhe praninë e NATO-s, që ndryshonte rrënjësisht konfigurimin gjeostrategjik dhe gjeopolitik të kësaj pjese të rajonit ku kryqëzoheshin interesat e ndryshme. Befasuese, megjithatë, ishte zhvillimi i saj i shpejtë, nga një kryengritje në dukje e kufizuar në një ambient malor të gatshëm për rebelim, siç ishte ai i Tanushës, në një ushtri, e cila ia doli që të kthehet në një faktor të fuqishëm lufte, që vuri në lëvizje të shpejtë faktorin ndërkombëtar për të ndërhyrë që ajo, me hovin që kishte marrë dhe epërsinë luftarake që demonstronte gjithnjë e më shumë dhe gjithnjë e më bindshëm në raport me forcat policore dhe ushtarake maqedonase, të mos rrezikonte ekzistencën e shtetit maqedonas, e me të të kthehet në një vatrë të re zjarri tejet e rrezikshme në rajon.

E parë nga aspekti ushtarak, kjo luftë shfaqej:

- *e organizuar mirë ushtarakisht,*
- *me dinamikë të përhapjes dhe*
- *e suksesshme për nga arritja e qëllimeve luftarake.*

*1. Organizimi i mirë ushtarak*, në përputhje me hierarkinë ushtarake, u vërejt nga transformimi e shpejtë i një kryengritje në “Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare” (UÇK), e cila filloi më 16 shkurt, 2001, me përleshjen e parë të një grupi luftë-

taresh nga Tanusha (shumë prej tyre kishin marrë pjesë në luftën e Kosovës) me njësitë policore të Maqedonisë, të pozicionuara në atë pjesë tek vendbanimi i quajtur Laku i Epërm.

Konflikti i armatosur kishte shpërthyer ngaqë luftëtarët shqiptarë, prej ditësh të pozicionuar në atë pjesë, nuk kishin lejuar që një patrullë policore të ngjitej në Tanushë. Me atë rast ishte vrarë luftëtari Muzafer Xhaferri, i njohur si dëshmori i parë i UÇK-së në Maqedoni.<sup>2077</sup>

Sipas shumë burimeve, konflikti i armatosur në Tanushë, prej kohësh ishte provokuar nga sjellja e forcave policore maqedonase, të cilat, jo rastësisht, në atë pjesë të kufirit me Kosovën, demonstroi dhunë, sidomos ndaj popullatës vendore, duke ua rrezikuar pronat, e mbi të gjitha qarkullimin e lirë në drejtim të Kosovës dhe anasjelltas, në mënyrë që të shpërnguleshin prej andej, projekt ky që kishte qenë thuarje në të gjitha agjendat edhe të regjimeve jugosllave, por që për politikën maqedonase e cila krekosej nga kursimi nga lufta, fitonte peshë të veçantë pozicionuzese për shkëputjen e saj nga Kosova dhe lidhjet jetësore me të. Dhuna policore prekte veçmas të rinjtë, të cilët, me “pretekstet” e kontrollimit të armëve ose të pjesëmarrjes në luftën e Kosovës, bastiseshin, keqtrajtoheshin dhe jo rrallë edhe dënoheshin me “fakte” të shpifura. Në përputhje me politikën provokuese ndaj shqiptarëve, në atë pjesë, prag të shpërthimit të luftës, u shfaqen postblloqe policore, ku edhe provokoheshin banorët e zonës kufitare. E gjitha, pra, bënte të ditur, se lufta e ardhshme po kërkohet dhe ishte e pashmangshme.

Sado që shpërthimi i luftës mund të merrej edhe si çështje e ndonjë reagimi të natyrshëm të grupeve të vogla ndaj dhunës policore, siç ishin ato me të cilat ballafaqoheshin banorët e brezit kufitar me Kosovën, megjithatë ngjarjet e Tanushës, dhe ato që u shfaqen në atë pjesë nga fillimi i janarit kur një tog luftëtarësh, i përbërë nga luftëtarët vendorë dhe ata të ardhur nga Kosova (ndër ta një skuadër nga katundi Baballoq i Dushkajës së Gjakovës, të cilët nuk ishin përfshirë në procesin e çmilitarizimit të UÇK-së),<sup>2078</sup> përfshihen në konfliktet e armatosura me patrullat policore, të cilave ua ndalojnë edhe hyrjen në katundet përreth, flasin për një organizim paraprak, që kishte tri qëllime.

---

<sup>2077</sup> Më gjerësisht rreth shfaqjes së UÇK-së në Tanushës si dhe organizimit të saj në përputhje me traditën e luftërave çlirimtare në këto anë, si dhe luftës së parë të njësitit të Tanushës me policët maqedonas, më 16 shkurt 2001, shih: Arifi, Feri: *“Tanusha në rrjedhat e historisë”*, Tetovë, 2015, faqe 297-315. Arifi, sjell edhe emrat e luftëtarëve të UÇK-së që morën pjesë në betejën e Lakut të Epërm. Ata janë: Muzafer Veli Xhaferri, Naim Selmani, të cilëve iu bashkëngjiten Idriz Selman Xhaferri dhe Bislim Alia. Në këto luftime u vra Muzafer Veli Xhaferri, i cili shënohet si dëshmori i parë i luftës së UÇK-së në Maqedoni.

<sup>2078</sup> Ostreni, Gëzim *“Ushtria Çlirimtare Kombëtare – shkaqet, lufta dhe pamjet në Maqedoni në vitin 2001”*, Dibër, 2014, faqe 162.

Së pari - që t'i jepej një përgjigje shtetit maqedonas ndaj provokimeve dhe diskriminimit të shqiptarëve në këto pjesë.

Së dyti - që Maqedonisë, t'i çirrej maska e rreme e “oazës së paqes”, siç propagohej në forumet meritore ndërkombëtare, ndërkohë që aty shqiptarët, me statusin e pakicës diskriminoheshin dhe keqtrajtoheshin thuajse në të gjitha fushat e jetës.

Dhe së treti -me luftë, Maqedonisë t'i imponohej opsioni politik për Maqedoninë - shtet dy kombesh.

Çështja e një kundërpërgjigje të armatosur provokimeve maqedonase në këto anë, del edhe nga vetë rrëfimi i gjeneral Gëzim Ostrenit, shef i Shtabit të Përgjithshëm të “Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare”.<sup>2079</sup>

Gjeneral Ostreni pranon se në vorbullën e këtyre përvijimeve luftarake, të cilat përhapeshin me të madhe dhe jo pa arsye, në Tanushë ishte dërguar një epror i larë i UÇK-së, si instruktor në këtë tog, prej nga to t'i jepej fizionomia e parë e brigadës 113 “Ismet Jashari – Kumanova”, që ishte themeluar pas pak, si formacion i parë i organizuar ushtarak në kuadër të “Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare” (UÇK).

Gjeneral Ostreni, ish shef i Shtabit të Zonës së Tretë të “Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës” dhe, asokohe, mbante detyrën e Komandantit të Zonës së Tretë Operative të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK), po ashtu, bën të ditur, se në mbrëmjen e 26 janarit, së bashku me instruktorin, në Tanushë arriti edhe një grup eprorësh (merret vesh nga Kosova).<sup>2080</sup>

Ata, menjëherë iu kishin rrekë punës, që kryengritësit të vepronin në kuadër të komandës së përbashkët dhe nën mbikëqyrjen e eprorëve profesionistë. Brenda dhjetë ditësh grupi prej 30 luftëtarësh ishte ndarë në tri togje, të cilat kishin zënë pozicione luftarake në atë pjesë.<sup>2081</sup>

---

<sup>2079</sup> Gjeneral *Gëzim Ostreni*, vjen nga Dibra. Ka kryer shkollën normale, ndërsa mbaron edhe Shkollën e Oficerëve rezervë dhe kurse të Akademisë së Lartë Ushtarake jugosllave. Në vitet e tetëdhjeta kryen detyrën e Komandantit të Mbrojtjes Territoriale në Dibër në kuadër të Armatës Jugosllave. Në luftën e Kosovës do të përfshihet nga fillimet e saj në detyrën e Shefit të Shtabit të UÇK-së së Zonës së Tretë, ku gjatë dhe pas transformimit të UÇK-së është komandant i zonës së tretë operative të TMK-së. Nga Qeveria e Përkohshme e Kosovës promovohet në gjeneral brigade të TMK-së. Në mars të vitit 2000, ngrihet në detyrën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Trupave Mbrojtëse të Kosovës me gradën e gjnerealmajorit. Me fillimin e luftës në Maqedoni merr detyrën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të “Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare”. Mbas luftës diplomohet në Fakultetin Filozofi Sociologji në Prishtinë, ku merr edhe gradën e doktorit të shkencave.

<sup>2080</sup> Shih: Ostreni, Gëzim: *Ushtria Çlirimtare Kombëtare – shkaqet, lufta dhe pamjet në Maqedoni në vitin 2001*, Dibër, 2014, faqe 162.

<sup>2081</sup> Ostreni, Gëzim *“Ushtria Çlirimtare Kombëtare – shkaqet, lufta dhe pamjet në Maqedoni në vitin 2001”*, Dibër, 2014, faqe 163.

Dëshmitë e gjeneralit Ostreni asokohe nga pozicioni i e Komandantit të Zonës së Tretë Operative të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) rreth organizimit të pjesëtarëve të UÇK-së nga Kosova në Maqedoni, flet për edhe për rolin dhe pjesëmarrjen e drejtpërdrejt të TMK-së në këtë zhvillim, gjë kjo që dëshmohet edhe me emërimin e tij shef i Shtabit të Përgjithshëm të “Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare”.

Sidoqoftë, konflikti i 16 shkurtit si dhe viktima e parë e saj nga radhët e UÇK-së, kishte alarmuar gjithë Maqedoninë. Mediumet zyrtare, të ushqyera nga informata e parë nga Tanusha që kishte sjellë ekipi televiziv A1, që ishte lejuar të hyjë atje dhe të filmojë luftëtarët e UÇK-së si dhe përkushtimin e tyre që, siç deklarorin, të mbrojnë popullatën nga dhuna shtetërore, kishte ngritë në këmbë edhe pushtetarët maqedonas. Më 19 shkurt 2001, ishte mbledhur edhe Këshilli i Sigurimit. Ishte marrë vendimi që në shkallë kombëtare të forcoheshin karakollët si dhe gjithë vija kufitare me Kosovën, prej nga thuhej se hynin luftëtarë në Maqedoni (ishte bërë edhe me gisht se prej kohësh atje, në pjesët që mbikëqyrte KFOR-i amerikan, stërviteshin pa kurrfarë vështirësish).

Nga kjo mbledhje, me tone dramatike për “rrezikun e terroristëve shqiptarë”, të shfaqur në Tanushë dhe brezin kufitar me Kosovën, ishin njoftuar Këshilli i Sigurimit të OKB-së, SHBA-të, NATO-ja, Rusia si dhe vendet e BE-së, ku edhe ishte sjellë një vendim për veprim “kundër terrorizmit”.<sup>2082</sup>

Alarmimi i opinionit të jashtëm, ishte përcjellë edhe me deklaratën e kryetarit B. Trajkovski kombit. Në mesazhin e 26 shkurtit 2001, bëhej me dije se Maqedonia me forcë do ta mbrojë sovranitetin dhe integritetin e saj. “Askush nuk duhet të dyshojë në vendosmërinë tonë për ta ruajtur integritetin territorial dhe sovranitetin e Republikës së Maqedonisë, si dhe paqen dhe qetësinë e qytetarëve tanë”.<sup>2083</sup>

Kryetari Trajkovski thërriste “të gjitha partitë politike të Republikës së Maqedonisë, pavarësisht nga ajo se a bëjnë pjesë në pushtetin ose janë në opozitë, pa dallim nga parashenja etnike, që t’u japin mbështetje të plotë aktiviteteve dhe përpjekjeve të shtetit të tyre, në interes të sigurisë dhe stabilitetit të tij”.<sup>2084</sup>

Me këtë rast, Trajkovski, para kombit, kishte deklaruar se “ekzistojnë pjesëtarë të uniformave të grupeve ilegale në pjesë të caktuara të brezit kufitare ndër-

---

<sup>2082</sup> Po aty. Ostreni, Gëzim “Ushtria Çlirimtare Kombëtare – shkaqet, lufta dhe pamjet në Maqedoni në vitin 2001”, Dibër, 2014, faqe 167.

<sup>2083</sup> „Дневник“, 26 .02.2001, cituar sipas Ostreni, Gëzim “Ushtria Çlirimtare Kombëtare – shkaqet, lufta dhe pamjet në Maqedoni në vitin 2001”, Dibër, 2014, faqe 167.

<sup>2084</sup> Po aty.

mjet Republikës së Maqedonisë dhe Jugosllavisë së mbetur, në pjesën nga Kosova”, me ç’rast kishte thënë se “është duke mbajtur kontakte të rregullta me funksionarët shtetërorë dhe me përfaqësues të NATO-s”, nga të cilët, “thotë se kemi përkrahje të plotë.”<sup>2085</sup>

Po ditën që kryetari Trajkovski, i ishte drejtuar kombit, kishte urdhëruar aksionet e para “për spastrimin nga terroristët”, në të cilat do të marrin pjesë disa njësi të Korpusit të Kumanovës si dhe brigadës së parë të këmbësorisë “Шкоп-тиони” nga Shtipi, që njihet si „njësi antiterror”. Forcat maqedonase kishin shkëmbyer zjarr me grupet e UÇK-së përreth Tanushës, por nuk ia kishin dalë të depërtonin në atë pjesë.<sup>2086</sup>

Pasi që ta ketë kuptuar realitetin, pra që njësitë e UÇK-së në pjesën e Tanushës, nuk mund të eliminohen me një “aksion” dhe se atje tashmë ndodhej një forcë ushtarake e organizuar mirë, që nuk mund të ndalej lehtë, me një letër, Trajkovski iu drejtua edhe Sekretari të Përgjithshëm të OKB-së dhe Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Kofi Annan. Në atë letër thuhej se “forcat maqedonase të sigurimit janë pothuajse për çdo ditë cak i sulmeve terroriste”, si pjesë e një “ekspansioni tradicional të një militantizmi radikal etnik” dhe se “Republika e Maqedonisë nuk ka alternativë tjetër, përveç ballafaqimit me një situatë në të cilën pjesë e territorit të saj në afërsi të kufirit është nën kontrollin e ekstremistëve militantë”.<sup>2087</sup>

Në këtë letër, Trajkovski e njofton Annanin, se “janë shterur të gjitha mjetet politike për t’i gjetur një zgjidhje paqësore kërcënimit serioz të integritetit territorial dhe sovranitetit të shtetit.”<sup>2088</sup>

Është interesant të thuhet se Trajkovski në letrën drejtuar Annanit përmend “ekspansionizmin tradicional të një militantizmi radikal etnik”, me ç’rast aludon te futja në lojë të të ashtuquajturave “ide shqiptaromëdha” si dhe rrezikun prej tyre, si për Maqedoninë, po edhe për rrethimin, me ç’rast, gishti drejtohet nga Kosova, prej nga ushqehen militantizmit radikal etnik.

Në këtë mënyrë, Trajkovski, duke fshehur shkaktarin e njëmendë të luftës në Maqedoni që së pari lidhet me përjashtimin e shqiptarëve nga shtetformimi si dhe me diskriminimin e tyre permanent gjatë dhjetë vjetësh, ai dëshiron t’ua hedh fajin “militantëve etnik”, me çka edhe kërkon të arsyetojë luftën kundër tyre në

---

<sup>2085</sup> Po aty.

<sup>2086</sup> Ostreni, Gëzim “*Ushtria Çlirimtare Kombëtare – shkaqet, lufta dhe pamjet në Maqedoni në vitin 2001*”, Dibër, 2014, faqe 167.

<sup>2087</sup> Po aty, faqe 167.

<sup>2088</sup> Po aty.

emër të “mbrojtjes së integritetit territorial dhe sovranitetit të shtetit”, paçka se ishte pikërisht ndërhyrja ushtarake e NATO-s në Kosovë që kishte thyer këtë tabu nga shkak se e drejta dhe sovraniteti shtetëror nuk mund të shfrytëzohet si alibi që shteti t’u shpallë luftë qytetarëve të vet, po qe se ata kërkojnë të jenë të barabartë dhe sovranë, siç kishte ndodhur me rastin e Kosovës.

Për Trajkovskin dhe ushtarakët maqedonas, kapja për “alibinë e sovranitetit dhe integritetit shtetëror” si dhe propaganda e hapur që e zhvilluan ata jashtë dhe brenda, veçmas brenda, duke i detyruar të gjitha forcat politike, pa përjashtuar edhe ato shqiptare, të bashkohen rreth saj, ishte një shkak i mirë që të intensifikohet veprimi luftarak kundër “terroristëve” në pjesët ku kishte shpërthyer revolta shqiptare. Kështu, më 4,5, 6 dhe 7 mars, forcat maqedonase (ato policore dhe ushtarake), të përcjella edhe nga artileria dhe helikopterët, filluan një operacion në drejtim të Tanushës. Në këtë luftime grupet e UÇK-së, në saje të manovrimeve taktike, ia dolën të zbrapsin sulmet e forcave maqedonase dhe madje, në Kodër të Furrës të marrin nën kontroll edhe pikën vështruese të UNPRED-it.<sup>2089</sup>

Ajo që doli nga ofensiva e parë e dështuar e forcave maqedonase drejt Tanushës, gjithsesi se nxori në pah fizionominë e parë ushtarake të UÇK-së, e cila u pasqyrua me një organizim të ri në përputhje me rrethanat. Kështu që, krahas formimit të Batalionit 113 “Ismet Jashari-Kumanova”, u mor vendimi që një kompani ushtarësh të UÇK-së në zhvillim për formimin e Brigadës 112 “Mujdin Aliu” të shumtën me luftëtarë nga Kosova, të fillojë të veprojë në pjesën qendrore të Maqedonisë Perëndimore, në rajonin e Tetovës. Po në këtë kohë merret vendimi edhe për formimin e Brigadës 115, në verilindje të Grapçanit, për të operuar në veri-perëndim të Maqedonisë. Kundërpërgjigjja e UÇK-së duhet t’i ketë befasuar jo vetëm maqedonasit, por edhe vëzhguesit e jashtëm, që nga afër përcillnin të gjitha zhvillimet në atë pjesë.<sup>2090</sup>

*2. Dinamika e përhapjes së UÇK-së - u vërejt që nga fillimet, kur nga pozicionet mbrojtëse që kishte në Tanushë dhe rrethim, pasi që të jetë sulmuar në vazhdim nga forcat e bashkuara policore dhe ushtarake maqedonase, si kundërpërgjigje ndaj opsionit tashmë të shpallur maqedonas që “terrorizmit shqiptar” t’i jepej “përgjigje ushtarake” në mënyrë që të çrrënjosej “aventurizmi i tyre ndaj Maqedonisë”, filloi përhapjen e shpejtë në pjesët tjera të banuara me shqiptarë, me çka në të vërtetë nis edhe *lufta për territore*.*

---

<sup>2089</sup> Po aty, faqe 172.

<sup>2090</sup> Po aty, faqe 174.

*Luftën për territore* UÇK-ja e zhvilloi me shumë sukses me shtrirjen në dy drejtime: në pjesën veri-perëndimore (Tetovë, Gostivar, Dibër, Kërçovë dhe Strugë) si dhe në pjesën lindore (në drejtim të Shkupit dhe të Kumanovës), duke vu nën mbikëqyrje pikat strategjike të komunikacioneve me të cilat në çdo kohë UÇK-ja mund të shpallte rreth një të tretën e Maqedonisë “territor të çliruar”.

Ky realitet do të mund të shfrytëzohej për formimin e njësisë autonome politike-territoriale të shqiptarëve në Maqedoni, ose për opsione të tjera politike “në ajër”.<sup>2091</sup>

Por, kur pritej që *njësive autonome-politike* t’u jipej një përgjigje në përputhje me opsionin e organizimit shtetëror mbi parimin federative, me Komunikatën numër 6 të UÇK-së nga 9 marsi, iu mbyll rruga. Në vend të kësaj, me Komunikatën numër 6, UÇK-ja doli në mbrojtje të integritetit territorial shtetëror të Maqedonisë, me sovranitetin e barabartë të të dy popujve: maqedonasve dhe të shqiptarëve.<sup>2092</sup>

Pas komunikatës numër 6, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, më 21 mars, kaloi nga katundi Bresanë i Prizrenit, për në Vicë të Tetovës dhe u vendos në një shtëpi, ku u bë e njohur se disa nga ata që deri më dje ishin në strukturat udhëheqëse të UÇK-së gjatë luftës së Kosovës, drejtonin luftën. Ndër ta, *Ali Ahmeti* shfaqej në postin e Komandantit të UÇK-së, ndërsa gjenerali *Gëzim Ostreni*, në atë të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm.<sup>2093</sup>

*Ali Ahmeti* dhe gjeneral *Ostreni* vinin nga Maqedonia (i pari nga Kërçova ndërsa i dyti nga Dibra), ku edhe kishin filluar veprimtarinë politike nga koha e ish Jugosllavisë, ose pas rrënimit të saj të përfshirë në radhët e “Lëvizjes Popullore të Kosovës”, dega e *Zvicrës*. Të dy ishin të njohur edhe për pjesëmarrjen në hierarkinë drejtuese të “Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”: *Ali Ahmeti* në strukturat e “Drejtorisë Politike të Shtabit të Përgjithshëm”, kur ato drejtoheshin nga *Shqi-përia*, ndërsa *Gëzim Ostreni*- pjesëmarrës në luftë, në strukturat komanduese, nga fillimet e deri në fund të saj.<sup>2094</sup>

Shtrirja në drejtim të Dibrës, Strugës deri në Kërçovë, si një koordinatë strategjike e UÇK-së dhe luftës së saj për territore, duhej të kalonte nëpër Tetovë dhe Gostivar. Parakushtet për këtë veprim u krijuan me 23 mars 2001, me krijimin e Brigadës 111 si dhe kyçjen e saj në luftimet në atë pjesë me anën e tri batalioneve në zhvillim: atë të Dibrës, të Strugës dhe të Kërçovës.

<sup>2091</sup> Shih: Pettiffer, James: “*Ushtria Çlirimtare e Kosovës*”, Tiranë, 2013, faqe 227.

<sup>2092</sup> Ostreni, Gëzim “*Ushtria Çlirimtare Kombëtare – shkaqet, lufta dhe pamjet në Maqedoni në vitin 2001*”, Dibër, 2014, faqe faqe 188.

<sup>2093</sup> Po aty, faqe 258.

<sup>2094</sup> Pettiffer, James: “*Ushtria Çlirimtare e Kosovës*”, Tiranë, 2013, faqe 275.

Veprimet luftarake të këtyre brigadave në ato pjesë nisën në fillim të prillit dhe, brenda një kohe të shkurtër, vunë nën mbikëqyrje të gjitha pikat strategjike në këtë pjesë me ç'rast ia dolën të mbikëqyrin komunikimet në rrugën Dibër-Mavrovë. Këto pozicione, luftëtarët e UÇK-së do t'i mbrojnë gjatë gjithë kohës. Forcat policore dhe ushtarake maqedonase herë pas herë merrnin veprime kundër tyre, por vazhdimisht tërhiqeshin nga mbrojtja e mirë e formacioneve të UÇK-së, të pozicionuara në këto pjesë.

Vlen të përmendet, se në kuadër të këtij organizimi të mirë ushtarak, Batalioni i Dytë i Brigadës 111, operoi në drejtim të Strugës dhe Ohrit me qëllim që të mbikëqyrej sipas nevojës ose të mbyllej rruga Ohër-Strugë. Ndërsa Batalioni i Tretë i Brigadës 111 në rajonin e Kërçovës. Gjatë korrikut dhe gushtit, këto batalione mbyllën rrugët Kërçovë-Gostivar si dhe ato Gostivar-Dibër në afërsi të Mavrovës.<sup>2095</sup>

Krahas shtrirjes së suksesshme nga Tetova për në Gostivar, Dibër dhe në drejtimet Strugë dhe Kërçovë, ku edhe u vendosën vija pak a shumë të qëndrueshme, por edhe mobile, nga marsi deri në gusht, UÇK-ja, ia doli që të hapë dhe të stabilizojë edhe frontin Verior – Kumanovë dhe atë Perëndimor – Kondovë.

Barrën kryesore në frontin e Kumanovës e barti Brigada 113 “Ismet Jashari – Kumanova”. Batalioni i parë i kësaj brigade u përqendrua në vijën Goshincë-Brezë, prej nga ushtri trysni në drejtim të komunës së Likovës, Sllupçamat për në Hotel dhe në drejtim të Kumanovës. Luftimet e kësaj Brigade, në këto vija të fronteve, bëheshin me qëllim që të futeshin nën mbikëqyrje dhe të bllokoheshin rrugët kryesore në Maqedoninë Veriperëndimore, në Malin e Zi (Karadaku) të Shkupit, Kumanovës e sidomos të bllokohet Shkupi.<sup>2096</sup>

Fronti Perëndimor, ai i Kondovës, mbahej nga Brigada 115. Vija e frontit ishte vendosur në jug dhe veri të Graçanit, duke mbyllur rrugën Kuçkovë-Graçan, me çka mundësohej edhe mbajtja në mbikëqyrje e rrugës Shkup - Han i Elezit, por jo e mbyllur (ngaqë nëpër të kalonin forcat e KFOR-t).<sup>2097</sup>

Kur flitet për dinamikën e shtrirjes, pra të përhapjes së UÇK-së, mund të thuhet se ajo ndoqi me sukses konceptin e një lufte për territore të caktuara, kryesisht të banuara me shqiptarë, dhe se ajo brenda një muaji, pra nga fillimi i marsit deri në fillim të prillit, arriti të gjitha koordinatat e parapara nga hapja e

---

<sup>2095</sup> Shih: Арцовски, Митре-Кузев, Стојан – Дамјановски, Ристо: „Војната во Македонија во 2001 година“, Скопје, 2006, стр.351. sipas Ostreni, Gëzim “Ushtria Çlirimtare Kombëtare – shkaqet, lufta dhe pamjet në Maqedoni në vitin 2001”, Dibër, 2014, 204.

<sup>2096</sup> Ostreni, Gëzim “Ushtria Çlirimtare Kombëtare – shkaqet, lufta dhe pamjet në Maqedoni në vitin 2001”, Dibër, 2014, faqe 278/79.

<sup>2097</sup> Po aty, faqe 280.



frontit në një gjatësi prej 100 kilometrash, mbajtje nën mbikëqyrje e iniciativës së luftës, ruajtja si dhe zmadhimi i forcës ushtarake e deri te krijimi i rrethanave për punë institucioneve lokale.<sup>2098</sup>

3. *Suksesi ushtarak i luftës së UÇK-së* - lidhet ngushtë me atë se ia doli që të përmbushë qëllimet e parashtruara luftarake, gjë që del të jetë organizimi më i suksesshëm ushtarak që shqiptarët zhvilluan gjatë dhe mbas shkatërrimit të ish Jugosllavisë. Edhe pse thuhet se UÇK-ja në Maqedoni zë fill nga rebelimi i një grupi të vogël luftëtarësh nga Tanusha dhe rrethina, me përvojë lufte në “Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës” dhe atë të Luginës së Preshevës, që silleshin deri në 30 ve-ta, të cilëve, thuhej, se u duhej mbështetje ushtarake, megjithatë, zhvillimet që dolën në pah nga fillimi i marsit e deri në fund të qershorit, tregojnë se “Ushtria Çlirimtare Kombëtare” kishte fizionominë e shfaqjes, planet dhe konceptin ushtarak në formën e një strategjie të përpunuar mirë e mirë nga pikëpamja profesionale (përmes veprimit të grupeve të vogla) prej nga, me të shpejtë do të kalohet në formacionet e organizuara, dhe se siç pranon edhe gjeneral Ostreni, roli i luftëtarëve nga Kosova të përfshirë në të dhe i vetë TMK-së (me këshilla profesionale) ishte i madh.<sup>2099</sup> Kjo do të dëshmohej sapo të fillojnë luftimet në pjesën e Tetovës dhe drejtimet kah Dibra, Struga dhe Kërçova si dhe në drejtim të Shkupit dhe të Kumanovës, prej nga, brenda tri javësh, krijohet një hark përgjatë kufirit të Kosovës dhe në drejtim të Serbisë si dhe përgjatë kufirit të Shqipërisë që shkonte nga veri (në pikëtakimin me Kosovën) e deri në jug (te liqeni i Ohrit).

Shtrirja në këto pjesë si dhe mbikëqyrja e tyre, UÇK-së i ofronte dy mundësi për zhvillimin e suksesshëm të luftës edhe po qe se ajo do të vazhdonte. E para, kishte të bënte me mundësinë e furnizimit të lirë me pajisje si dhe me armatime nga Kosova dhe nga Shqipëria në çdo kohë. Konfigurimi i përshtatshëm gjeografik (rrugët e shumta malore) mbeteshin gjithmonë të hapura edhe po qe se disa prej tyre do të “mbikëqyreshin”. Dhe e dyta, nga këto pjesë, UÇK-ja, po ashtu, sipas nevojës, në forma të ndryshme, por shumë të përshtatshme, ruante vijat e hapura të bartjes së formacioneve ushtarake në Kosovë dhe në Shqipëri si dhe lëvizjes së tyre taktike në pjesë të ndryshme në të cilat forcat policore dhe ato ushtarake maqedonase nuk mund të depërtonin. Ky hark strategjik do të përmbush hallkën e fundit nga mesi i qershorit me hyrjen në Haraçinë, prej nga

---

<sup>2098</sup> Po aty, faqe 291.

<sup>2099</sup> Po aty, faqe 187-172.

praktikisht mbikëqyrej Shkupi, pjesa përreth, rrugët në drejtim të Kosovës dhe të Serbisë si dhe aeroporti ndërkombëtar i Shkupit. Kësaj mbikëqyrje strategjike ia shtonin peshën edhe pozicionet fortifikuese të UÇK-së në një pjesë të Karadakut si dhe përreth Kumanovës prej nga mund të operohej me lehtësi luginave që shtriheshin në drejtim të Kumanovës dhe të Shkupit.

Edhe pse shërbimet informative të Maqedonisë (ato policore dhe ushtarake të ndihmuara nga ekspertët e Beogradit dhe të Ruisë), mund të kishin njoftime të bollshme rreth veprimtarisë së grupeve “terroriste”, si quheshin luftëtarët që kishin marrë pjesë në luftën e UÇK-së në Kosovë dhe atë të Luginës së Preshevës, siç kishin njoftime edhe shërbimet e KAFOR-it dhe forcat amerikane të stacionuara në kufirin me Maqedoninë për ushtrimet dhe grumbullimet e tyre në brezin kufitar me Maqedoninë (ku nuk mungonin edhe informatat për veprimet e forcave policore dhe ushtarake të Maqedonisë në këtë brez kufitar, veçmas kur përdorin dhunën ndaj banorëve të kësaj pjese), megjithatë, maqedonasit e kishin provokuar luftën nga bindja se e gjitha mund të mbetej në përmasat e ndonjë reagimi të shkëputur, në formën e ndonjë konflikti ad-hoc, ngaqë luftëtarët e shkapërdhur të UÇK-së nëpër Kosovë dhe Maqedoni edhe po qe se do të joshën nga dika, nuk do të jenë në gjendje të nisin një luftë tjetër, pas asaj në Luginën e Preshevës, kur KFOR-i po edhe amerikanët, jo vetëm që nuk u kishin dhënë përkrahje, por kishin lejuar që, në një marrëveshje me Armatën Jugosllave, asaj t’ia rikthejnë edhe mundësinë që të operojë edhe në zonën e sigurisë, prej pesë kilometrash, ku kishin pasur mbështetjen kryesore të veprimit.

Duke u mbështetur në disfatën e UÇPMB-së si dhe përfitimeve që vlerësohej se kishte pasur Beogradi, veçmas duke mos u përfillur referendumi i popullata shqiptare e Luginës së Preshevës për autonomi kulturore dhe territorial i mbajtur në vitin 1992, edhe Shkupi zyrtar, mund të kishte llogaritur se kryengritësit shqiptarë dhe karta eventuale e “Iliridës”, do t’ua humbte çfarëdo mbështetje nga faktori ndërkombëtar, që përkrahte shtetin e pavarur maqedonas.

Pavarësisht këtyre hesapeve që nuk mund të përjashtohen aty ku historikisht dhe politikisht çështjet mbesin të hapur, veçmas siç ishte ajo shqiptarja, e cila përherë është shfaqur si strumbullar i të gjitha krizave në këto hapësira pikërisht pse është injoruar ose anashkaluar, realiteti doli të ishte tjetër, ngaqë grupet “e vogla terroriste”, nuk ishin “provokues” të thjeshtë, që matnin “pulse” të ndryshme, e as “mercenarë” fesatesh me orar të caktuar, por ishin formacione të përgatitura ushtarake, fuqia e të cilave doli shpejt në pah, që brenda 3-4 javësh, jo vetëm që u dëshmuar, por krijoi “fakte të kryera” me vijat e fronteve stabile dhe me

hapësirat që kontrollonte, e deri te aksionet guerile në pjesë të caktuara vitale, prej nga tërhiqej me shpejtësi me humbje minimale, me çka bënte të ditur se ishte në gjendje që luftën ta përhapte në çdo pjesë të vendit.

Në të vërtetë, luftimet brenda marsit e deri nga mesi i prillit, nxorën në pah në një rën anë aftësinë mobilizuese dhe manovruese të UÇK-së si dhe sjelljen profesionale të luftëtarëve të saj, të përgatitur mirë dhe të pajisur me armatime të lehta e tepër të sofistikuar kundër njësisive të blinduara deri te armët kundër-ajrore, dhe në tjetrën anë nxorën në pah paaftësinë e policisë dhe ushtrisë maqedonase, të përballej me UÇK-në dhe formacionet e saj si dhe lëvizjet e saj taktike dhe strategjike, përkundër njësisive “antiterror” dhe të tjera të ushtruara nga ushtarakë serbë, rusë dhe të tjerë e ku kishte edhe mercenarë nga jashtë.

Dëshpërues për shtetin maqedonas doli edhe organizimi i forcave të tyre të armatosura, të cilat, përkundër fjalëve të mëdha që thuheshin nga oficerët e saj të lartë si dhe premtimeve boshe nëpër mitingje dhe emisione televizive, u pa, se ishin fare të papërgatitura për sfidën luftarake, me të cilat po përballeshin.<sup>2100</sup>

Kjo madje, u vërejt edhe nga vëzhguesit ndërkombëtarë, të cilët, po përcillnin nga afër betejën për Tetovën, të 22 marsit, me ç’rast u binden se kjo betejë nuk do të fitohej kurrë nga maqedonasit dhe se aty ishin luftëtarët shqiptarë që kishin iniciativën dhe mund të shtriheshin edhe në pjesët përreth.<sup>2101</sup>

Nuk vonoi dhe të ky përfundim, erdhën edhe vëzhguesit e NATO-s si dhe faktorët ndërkombëtarë që po monitoronin gjendjen nga afër, të cilët, zunë të shqetësohen se opsioni i shtetit maqedonas “për zgjidhjen e konfliktit”, me “anën e luftës”, që vazhdimisht e rrihte, përkundër pa aftësisë në fronte si dhe vitalitetit të UÇK-së që ta tërhiqte për hunde armatën maqedonase. Kjo e detyroi faktorin ndërkombëtar që të fusë në lojë kartën e “ndërprerjes së luftimeve”, “bisedimet” e deri te “marrëveshjet për paqe”.

Në pamundësi që të dëshmohejshin nëpër beteja, ku rëndom pësonin humbej të njëpasnjëshme, ose tërhiqeshin gjoja “për arsye taktike”, njësitë policore dhe

---

<sup>2100</sup>Forcat e Armatosura të Maqedonisë, në letër, përbëheshin nga 18 mijë ushtarë të rregullt dhe 85 mijë rezervistë. Kjo forcë hipotetike, ishte e papërgatitur ushtarakisht. Nëse kësaj i shtohet edhe fakti se mbi një e treta e ushtarëve ishin shqiptarë, atëherë shihej qartë se ajo nuk ishte as në gjendje që të merrte përsipër ndonjë veprim luftarak, përkundër faktit se në radhët e saj kishte edhe njësi speciale (“Shkorpioni” dhe “Vollci”, kryesisht mercenarë). Policia e Ministrisë së Brendshme ishte më e organizuar. Përbëhej nga 7600 pjesëtarë, të organizuara sipas modelit të njësisive antiterroriste serbe (JSO). Edhe armatimet e ushtrisë Maqedonase nuk ishin të ndonjë cilësie. Kishte tre tanke T-34 me top 100 milimetra dhe një bateri me dy raketahedhës me nga 16 gryka. Kishte edhe disa helikopterë, që u mungonin pilotë e ushtruar. Së voni kishte marrë disa helikopterë nga Ukraina. (Ostreni, Gëzim: “Ushtria Çlirimtare Kombëtare”, Dibër, 2014)

<sup>2101</sup>Pettifer, James: “Ushtria Çlirimtare e Kosovës”, Tiranë, 2013, faqe 277.

ato ushtarake maqedonase përpiqeshin që disfatat ushtarake t'i zhdëmtonin me dhu-në ndaj objekteve civile si dhe veprime të tjera kundër popullatës në pjesët ku operoni njësitë e UÇK-së. Kjo u pasqyrua ndaj qytetit të Tetovës, në Likovë si dhe vendbanimet malore në drejtim të Kumanovës, ato në pjesën nga Kosova dhe në drejtim të Dibrës dhe Gostivarit. Gjithsesi në shënjestër të hakmarrjeve të forcave policore dhe ushtarake ishte Tetova me rrethinë, ku forcat e UÇK-së hynin e dilnin pa ndonjë vështirësi dhe mund ta mbanin të rrethuar madje, dhe sidomos pjesa malore në drejtim të Sharit, ku përdroreshin tanket si dhe helikopterët ushtarakë për t'i rrënuar pamëshirshëm pjesët urbane si dhe infrastrukturën rrugore.

Kjo bëri që një pjesë e madhe e popullatës së atyre pjesëve të zhvendosej drejt Shkupit, ose të kalonte kufirin për në Kosovë (kryesisht) po edhe në Shqipëri, me çka Maqedonisë po i kërcënohej një krizë humanitare.

Krahas veprimeve të forcave policore dhe atyre ushtarake në shenjë hakmarrjeve në pjesët urbane të Tetovës dhe qyteteve të tjera të Pollogut me shumicë shqiptare, dhunë e shfrenuar zu të ushtrohej edhe ndaj shqiptarëve të Shkupit nga njësitë paramilitare dhe të tjera, që demonstironin me histeri kundër shqiptarëve, duke kërkuar që të dëboheshin për në Shqipëri, ndërkohë që sulmonin edhe pronat e tyre (dyqanet, punëtoritë si dhe shkollat ku mësonin fëmijët shqiptarë).

Pamjet që kompanitë e mëdha televizive botërore (BBC, CNN, N-TV e tjera), ku pasqyrohej shfrenimi antishqiptar ndaj popullatës civile si dhe pronave të tyre në Shkup dhe gjetiu, ndikuan që opsioni i zgjidhjes ushtarake, që ofronte qeveria maqedonase gjoja “kundër terroristëve”, (gjithnjë duke u mbështetur se atë duhej ta bënte NATO-ja), bënë që në opinion, faktori ndërkombëtar të shfaqej me opsionin e një marrëveshjeje me luftëtarët shqiptarë, që nënkuptonte edhe kërkesat politike, të cilat, në ato rrethana, dihej se çfarë mund të ishin.

Në këto rrethana, UÇK-ja vendosi që me disa njësi t'i afrohej pjesës së Shkupit të banuar me shqiptarë, në mënyrë që t'i mbronin nga paramilitarët maqedonas, të cilët vepronin shlrshëm ditën dhe natën.

Krahas kësaj, me gatishmërinë që të futej në Shkup, UÇK-ja, dëshironte të ushtronte trysni të dyfishtë edhe ndaj faktorit ndërkombëtar: në njërin anë që të pranonte se Maqedonia e shpallur si shtet kombëtar i maqedonasve, e vlerësuar prej vitesh “si oazë paqeje” që edhe më tutje po i jepeshin përkrahje dhe premtime për asocim në BE<sup>2102</sup> dhe të ngjashme me të cilat joshej pareshtur që të ruante kur-

---

<sup>2102</sup> Në kuadër të joshjes, Maqedonia, më 9 prill 2001 nënshkroi marrëveshje për Stabilizim dhe Asocim me Bashkimin Europian. Kusht për këtë, ishte që Maqedonia t'i jpte fund konfliktit me shqiptarët dhe se e gjitha

sin “demokratik”, nuk ishte tjetër pos një krijesë e paqëndrueshme, që mund të destabilizohet në çdo kohë, dhe në tjetrën anë, të bënte të ditur se ishin pikërisht shqiptarët dhe diskriminimi i tyre nga ana e shtetit maqedonas i ndërtuar mbi arrogancën nacionaliste, që kishte sjellë luftën, që për t’u ndalur nuk i bënte “terapia e luftës kundër terrorizmit”, siç vepronte Shkupi zyrtar, përkundër humbjeve që pësonte në planin ushtarak, por shqyrtimi i kërkesave të shqiptarëve dhe arritja e një marrëveshje me ta me anën e ndërmjetësimit të faktorit ndërkombëtar.

Në të vërtete, depërtimi i UÇK-së në Haraçinë, më 11 qershor, u nxit nga dy veprime paralele të maqedonasve: në njërën anë të demagogjisë së Planit të Paqes të kryetarit Boris Trajkovski, me të cilin ai dëshironte të arrinte mbështetjen e faktorit ndërkombëtar që me propozime kozmetike ta fusë në grackë faktorin politik shqiptar në Maqedoni që të distancohet nga lufta e UÇK-së me thashetheme se ajo tashmë ishte e humbur. Ndërsa në tjetrën anë, “vullnetin për paqe” që po e paraqiste në “drejtim të shqiptarëve si dhe faktorit ndërkombëtar”, ta shfrytëzonte për operacione ushtarake kundër UÇK-së në dy faza, duke futur në veprim thuajse të gjitha mjetet: nga artileria e deri te aviacioni. Sipas Fazës së Parë të operacionit, forcat qeveritare do të përpiqeshin që, duke hedhur disa njësi të “Uj-qërve” si desantë me helikopterë në pikat më të rëndësishme (kodrinat), t’i rrethojë njësitë e UÇK-së në rajonet e katundeve Mateç, Hotël, Orizore dhe Sllupçan, ndërprerjen lidhjen drejtë Likovës dhe zhdukjen e depove të UÇK-së.<sup>2103</sup>

Në Fazën e Dytë, operacioni duhej të fokusohet në veprime për shpartallimin, ndjekjen dhe zhdukjen e tërësishme të njësiteve të vogla të grupeve të mbetura.<sup>2104</sup>

Meqë këto veprime luftarake të forcave të përbashkëta policore dhe ushtarake të Maqedonisë, siç ndodhte rëndom, kishin dështuar, ndërkohë që propaganda qeveritare vazhdonte të mashtronte për “arritjen e qëllimeve luftarake” kundër “terroristëve”, mashtrime këto që bëheshin me anën e xhirimeve fiktive televizive, ndërsa ky spektakël televiziv zuri të merrte mbështetje edhe nga NATO-ka dhe Rusia (në takimin midis sekretarit të përgjithshëm Robertson dhe ministrit rus të mbrojtjes, Ivanov në Bruksel), ndonëse i dinin realitet ushtarak si dhe gjimnastikën e presidentit Trajkovski me “nismat paqësore”, UÇK-ja, pas lëshimeve të shumta “me përmbajtjen që të mos depërtonte ushtarakisht në disa pjesë strategjike” dhe pas pranimit që t’i jepej rast politikës për arritjen e një marrëveshje

---

duhej të arrihej deri më 15 qershor, kur në Samitin e Geteburgut. Nga BE- Maqedonisë, po ashtu, premtuan edhe programe zhvillimore dhe ndihma të tjera me të cilat “do të ndërtohej paqja e brendshme”.

<sup>2103</sup> Ostreni, Gëzim: “*Ushtria Çlirimtare Kombëtare – shkaqet, lufta dhe pamjet në Maqedoni në vitin 2001*”, Dibër, 2014, faqe 568.

<sup>2104</sup> Po aty.

paqësore, vendosi që të kundërpërgjigjej me futjen në paralagjet e Shkupit, në Haraçinë, të cilën e vuri nën mbikëqyrje më 11 qershor 2001.

Futja e UÇK-së në Haraçinë si dhe shpartallimi i njërive policore në atë pjesë, ikja e tyre duke lënë pas edhe armatimet, krijoi panik në Shkup, veçmas te pjesa e asaj popullate që ishte mësuar me lajmet zyrtare rreth “fitoreve ndaj terroristëve” dhe mund edhe t’u besonte, si dhe huti te pjesa e vëzhguesve ndërkom-bëtarë, që ishin në anën e maqedonasve.

Por, për NATO-n dhe veçmas për pjesën amerikane në të, futja e UÇK-së në paralagjet e Shkupit nuk paraqiste ndonjë befasi, ngaqë kishte njoftime të bollshme rreth aftësisë luftarake të UÇK-së si dhe fjalëve boshe të qeveritarëve maqedonas rreth zgjidhjes së konfliktit me anën e “opsionit të luftës”.

Duke ditur këto realitet, për të mbajtur gjendjen nën mbikëqyrje, amerikanët, ua tërhoqën vërejtjen komandantëve të UÇK-së “që lufta të mos bartej në Shkup”.<sup>2105</sup>Ndërsa nga qeveria e Maqedonisë u kërkua që të parandalonte provokimet ndaj popullatës shqiptare në Shkup si dhe veprimet e dhunshme të paramilitarëve në lagjet shqiptare.<sup>2106</sup>

Shikuar nga pikëpamja e aftësisë ushtarake, UÇK-ja do të mund të hynte edhe më herët në Shkup dhe madje ta rrethonte atë në të gjitha anët, po mos të pengohej nga stacionimi i njërive të NATO-s, në pjesën veriore, të cilat u vendosën nga mesi i majit në atë pjesë, me ç’rast në dy katunde përreth, vëzhguesit e NATO-s çarmatosën disa grupime të UÇK-së për të cilat dyshohej se synonin futjen në pjesën veriore të Shkupit të banuar me maqedonas.<sup>2107</sup>

Në pamundësi të fshihet depërtimi i UÇK-së në Haraçinë, ministri i brendshëm Boshkovski, u shfaq me një apel dramatik drejtuar opinionit ndërkombëtar se si në Haraçinë kishte 700-800 “terroristë”, për të cilët tha “se i kanë marrë në duar të gjitha vendet strategjike bashkë me shtëpitë e banorëve të këtij vendbanimi.”<sup>2108</sup>

Apeli dramatik i Boshkovskit nuk ishte pa gjë, ngaqë nga ajo pjesë, luftëtarët e UÇK-së mbanin në shënjestër objektet kryesore strategjike të Shkupit dhe rrethinës: aeroportin ndërkombëtar të Shkupit, kazeremat, rafinerinë e naftës dhe autostradën Beograd-Athinë, të cilën mund ta bllokonin në çdo kohë.<sup>2109</sup>

---

<sup>2105</sup> “Fakti”, më 12 qershor, 2001; “Дневник”, 12 06 2001.

<sup>2106</sup> “Fakti”, më 13 qershor, 2001.

<sup>2107</sup> Pettifer, Jams: “Ushtria Çlirimtare e Kosovës”, Tetovë, 2013, faqe 278.

<sup>2108</sup> Ostreni, Gëzim: “Ushtria Çlirimtare Kombëtare – shkaqet, lufta dhe pamjet në Maqedoni në vitin 2001”, Dibër, 2014, faqe 570.

<sup>2109</sup> Po aty.

### Aspekti diplomatik i luftës – ndërkombëtarizimi

Depërtimi i UÇK-së në Haraçinë të Shkupit, mbajtja por edhe forcimi i pozicioneve në pikat kodrinore përreth Kumanovës me të cilat mbikëqyreshin rrugët hekurudhore dhe ato automobilistike me Serbinë si dhe kalimet tjera drejt pjesës qendrore, shtrirja në zonën kufitare me Kosovën (në pjesën e Elez Hanit) si dhe mbikëqyrja e plotë që kishte në pjesën nga Tetova për në Gostivar, Dibër e deri në Strugë dhe Kërçovë, në mediat botërore nxorën pamjen e një Maqedonie, e cila në luftë me UÇK-në, jo vetëm që nuk po ia dilte, që siç kishte premtuar kryeministri Georgievski që “agresionit terrorist”, që vinte edhe nga Kosova,<sup>2110</sup> t’i jepte përgjigje ushtarake, por gjithnjë e më shumë linte përshtypjen se nga krekosja dhe nga kokëfortësia që të pranonte fuqinë e faktorit shqiptar në Maqedoni, ishte në rrugë e sipër që të shpërbëhej si shtet, me çka rajoni do të përballej me një krizë, ndoshta më të madhe nga ajo që përcjelli shpërbërjen e ish Jugosllavisë.

Këtu dhe te kjo pikë duhet parë aspektin diplomatik të ndërkombëtarizimit të çështjes shqiptare në Maqedoni nga lufta e UÇK-së. Këtu, gjithsesi se “merita” të shumta ka edhe faktori ndërkombëtar, në radhë të parë OKB-ja, BE-ja, OSBE-ja e të tjera, që në vend se më kohë të parandalonin shkaktarin kryesor të kësaj krize të programuar – krijimin e shtetit kombëtar maqedonas, duke injoruar faktorin etnik shqiptar në të, i cili edhe në Republikën Jugosllave të Maqedonisë, me kushtetutën e vitit 1974 kishte pozitën e barabartë, kaloi sikur shfaqja e shtetit maqedonas i shpallur mbi parimin komb-shtet, ndonëse me telashe të përhershme në Ballkan, të ishte receta e vetme e mundshme për shtetin më të ri në Ballkan, paçka se kjo u kundërshtuar nga shqiptarët, të cilët jo vetëm nuk morën pjesë në konstituimin e tij, por iu kundërpërgjigjen me mbajtjen e Referendumit për Autonomi Territoriale dhe Politike në Maqedoni.<sup>2111</sup>

Edhe pse shqiptarët nuk u sollën përgjegjshëm ndaj Referendumit për pavarësi dhe sikur e harruan pas pak, duke u kyçur në jetën institucionale dhe në strukturat e pushtetit, megjithatë ishte kjo një shenjë e mjaftueshme që rruga e shpalljes së shtetit maqedonas si shtet i kombit maqedonas të rishqyrtohej para se

---

<sup>2110</sup> Kryeministri Lubço Georgievski, në mbledhjen e jashtëzakonshme të qeverisë, më 15 mars 2001, kishte bërë një deklaratë, në të cilën kishte theksuar, pos tjerash, se “Në fillim shteti ballafaqohej me sfidën për eliminimin e grupeve terroriste, të cilat vinin nga territori i Jugosllavisë, gjegjësisht i Kosovës. Më vonë ajo u shndërrua në aktivitate të armatosura të shpeshtuara dhe sulme mbi objektet virale me rëndësi të veçantë, këstu që ditëve të fundit t’i përjetojmë thirrjet e hapura kundër rregullimit shtetëror, rrezikimit të rendit kushtetues dhe sigurisë së vendit tonë me identifikim të hapur dhe identifikimin publik të kryerësve të këtyre veprimeve terroriste”. (Shi: “Дневник”, 16 03. 2001).

<sup>2111</sup> Rexhepi, Zeqirija: “Zhvillimet politiko shoqërore të shqiptarëve në Maqedoni 1990-2001”, Tetovë, 2005, faqe 44.

të bëhej vonë dhe se ajo mund të prodhonte kriza por assesi stabilitet. Kjo jo vetëm që nuk ndodhi, por Maqedonisë zunë t'i vinë lavde nga të gjitha anët. Si e tillë, në vitin 1993, edhe u pranua në OKB me çka ndërkombëtarisht u pranua koncepti i një shteti nacional.<sup>2112</sup>

Lavde, madje Shkupi zyrtar mori edhe atëherë kur jo vetëm që nuk lejoi mësimin në gjuhën shqipe në universitetin shtetëror, por edhe kur mori masa të ashpra që të pengojë hapjen e Universitetit të Tetovës me mësim në gjuhën shqipe, i cili u detyrua që të financohet nga donacionet private.<sup>2113</sup>

Sulmet ndaj Universitetit të Tetovës si dhe diskriminimi i studentëve shqiptarë që të studiojnë në gjuhën amtare, preokupuan edhe Këshillin e Europës, i cili aprovoi një rezolutë në këtë drejtim. Reagime pati edhe nga disa universitete evropiane, të cilat kritikuan ashpër politikën diskriminuese të shtetit maqedonas ndaj shqiptarëve.<sup>2114</sup>

Por, do të jetë thadrimi i krizës në ish Jugosllavi (përhapja e luftës në Kroaci si dhe në Bosnje dhe Hercegovinë) dhe brenga që ajo të përfshinte edhe Kosovën, ku faktori ndërkombëtar ishte përqendruar këmbë e krye, që Shkupit ia hoqën dertin e diskriminimit të shqiptarëve, duke përfshirë këtu edhe atë të Universitetit të Tetovës.

Kjo gjendje, megjithatë, që dihej se një ditë merrte fund, ndryshoi me shfaqjen e luftimeve të para midis grupeve kryengritëse në Tanushë dhe rrethinë në fillim të shkurtit 2001.

Dhe, çastin që kryeministri maqedonas, L. Georgievski doli me njoftimin se “Maqedonia ishte sulmuar nga grupe terroriste që vinin nga Kosova”, ndërsa televizioni A-1 dha pamje të grupeve të armatosura shqiptare në Tanushë, faktorët ndërkombëtarë reagueshan trembshëm sikur të zgjoheshin nga një gjumë i zhytur në makthe.

---

<sup>2112</sup>Kiro Gligorov, kryetar i Maqedonisë, në foltoren e OKB-së, më 8 prill 1993, shpalosi një histori politike të popullit sllavo-maqedonas, lashtësinë e tij, etnokulturën si dhe identitetit shtetëror të lidhur me Republikën e Krushevës, të vitit 1903 dhe me mbledhjen e ASNOM-it në vitin 1945 kur u krijua Maqedonia, që u përfshi në Jugosllavi. Pra, Gligorovi, foli për formimin e shtetit-komb dhe të maqedonasve si komb-shtet, të shumën në frymën e një retorike historike, pa mbështetje në realitetet historike. (Shih fjalën e K. Gligorovit në OKB, në “Дневник”, 9 .04. 1993).

<sup>2113</sup> Nisma për themelimin e Universitetit në gjuhën shqipe në Tetovë filloi më 4 qershor 1994, nga Kuvendi i Intelektualëve shqiptarë të rangut universitar, së bashku me përfaqësuesit e asociacioneve të ndryshme dhe të subjekteve politike. Univeristet i Tetovës u themelue në seancën solemne të mbajtur më 17 dhjetor 1994. (Shih: Rexhepi, Zeqirija: “Zhvillimet politiko-shoqërore të shqiptarëve në Maqedoni 1990-2001”, Tetovë, 2005, faqe 108-115).

<sup>2114</sup> Shih: “Rilindja”, 25 mars 1996, rreth vizitës së përfaqësuesve të Universitetit të Tetovës, të kryesuar nga rektori dr.prof. Fadil Sulejmani në Bruksel dhe Bon si dhe reagimet e studentëve shqiptarë në universitete e Bohumit, Berlinit dhe të Brukselit.



Natyrishet se ishin amerikanët ata që morën nismën diplomatike për t'i dhënë fund kryengritjes, ndonëse nuk kishin ndonjë plan si të arrihej kjo, e gjitha duhej të fillonte me një ndërmjetësues “gjithëpërfshirës”, me një diplomat të rryer dhe njohës të realiteteve të atjeshme, i cili do të shkonte me mandatin e OSBE-së. Amerikanët u përcaktuan për diplomatin e tyre Robert Frowick, i cili, brenda një muaji duhej të arrinte pajtimin ndëretnik në Maqedoni, me çka u pranua fakti se aty kishte mospajtime etnike,<sup>2115</sup> për ç'gjë ishte heshtur qëllimisht.

Fillimi i misionit të Frowickut si dhe puna e tij jo vetëm që nuk ndalën konfliktin, siç pretendonte diplomati i rryer amerikan, por ai, pa se pas vendimit të qeverisë maqedonase që “terroristëve t'u jepte përgjigje me luftë”, po merrte përmasat e një lufte të hapur, në të cilën, UÇK-ja, pos që depërtonte në disa drejtime, po ashtu tregonte se ishte e pamposhtur nga forcat policore dhe ushtarake maqedonase, dhe njëherësh e aftë që të marrë nën kontroll pikat strategjike rrugore të vendit dhe, në rast nevojë, të futet edhe në Shkup dhe në qytetet tjera me popullatë shqiptare, po edhe me atë të përzier, ku praktikisht shteti maqedonas do të shpërbëhej.

Paaftësia e ushtrisë maqedonase, që konfliktin ta zgjidh me luftë, siç ia nisi, dhe aftësia e UÇK-së luftën ta shfrytëzojë për qëllime politike, me çka hapej edhe një krizë e re në rajon mbas asaj të ish Jugosllavisë, futi në lojë NATO-n, amerikanët dhe BE-në, ngaqë të gjithë ishin të vetëdijshëm se çfarë mund të pille ajo nëse vazhdonte siç kishte nisur.

Me këtë shqetësim, më 26 mars 2001, vijnë në Shkup Javier Solana dhe Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, lordi Xhorxh Robertson.

Ardhja e Solanës dhe Robertsonit në Maqedoni në të vërtetë paraqet të arriturën më të madhe të luftës së UÇK-së në planin diplomatik për ndërkombëtarizimin e çështjes shqiptare në Maqedoni, ndërkombëtarizim, që ndonëse përcillej me mesazhe për “mbrojtjen e integritetit territorial dhe sovranitetit shtetëror” të Maqedonisë si dhe “kërcënimet që u dërgoheshin atyre që e rrezikonin këtë” e të ngjashme, të cilat përsëriteshin në konferenca për shtyp, Maqedonia nuk do të ishte ajo e djeshmja, shtet kombëtar i maqedonasve, së cilës epilogu i luftës së

---

<sup>2115</sup> Diplomati amerikan *Robert Frowick*, kishte punuar në Maqedoni si diplomat i parë i OSBE-së në vitin 1992, e pastaj si drejtor i parë i ekzekutiv i organizatës joqeveritare “Kërkimi i bazës së përbashkët” në Maqedoni në vitin 1994. Frowick kishte paraparë që aktivitetin ta zhvillojë në tri faza: E para lidhej me formimin e një grupi koordinues ndëretnik, i përbërë nga të dyja partitë e mëdha politike maqedonase dhe shqiptare. Së dyti, formimin e një qeverie të unitetit nacional dhe në fund, fillimin e një procesi paqësor, duke bërë trysni që t'i jepet fund dhunës dhe të tërhiqen ekstremistët shqiptarë të Kosovës, me qëllim që të pastrohet rruga për dialog politik të aftë për të prodhuar marrëveshje dhe pajtim. (Shih: Ostreni, Gëzim : “*Ushtria Çlirimtare Kombëtare*”, Dibër, 2014, faqe 351-355).

shqiptarëve do t'ia përcaktonte karakterin, përmasat e së cilës, ndërkombëtarët kërkonin që të mbeteshin brenda për brenda kornizave të integritetit territorial dhe të sovranitetit shtetëror dhe garancioneve për të, gjë që kjo, nga ana e UÇK-së do të jepet me Komunikatën numër 6 të 9 marsit 2001, ku shfaqet edhe pozicionimi themelor i UÇK-së rreth ruajtjes dhe integritetit territorial të Maqedonisë, i kushtëzuar me këto kërkesa:

1. Ndërmjetësim ndërkombëtar për zgjidhjen e çështjeve kontestuese, nga të cilat lindi konflikti dhe
2. Ndryshim të Kushtetutës së Maqedonisë, që Maqedonia të jetë shtet i dy popujve: shqiptaro-maqedonas, përkatësisht maqedonaso-shqiptar.<sup>2116</sup>

Edhe pse Robertson nuk u takua me përfaqësuesit e UÇK-së, është më se e qartë që zotimin e UÇK-së për respektimin e integritetit territorial si dhe të sovranitetit shtetëror të Maqedonisë, të shprehur në Komunikatën numër 6 do ta ketë dëgjuar, madje në katër sy, si porosi nergut për të nga ndonjë i dërguar i Ali Ahmetit, nga periferia e Tetovës, ku kishte shtabin e luftës, zotim ky që mund ta kishte qetësuar sekretarin gjeneral të NATO-s.

Porosia që kishte dalë nga Komunikata numër 9 e UÇK-së çojnë te fillimi diplomatik i shqyrtimit të kërkesave politike të UÇK-së, me çka, përkundër përkrahjes verbale që i jepej udhëheqjes maqedonase gjatë takimeve të niveleve të ndryshme nga ndërkombëtarët “për ta mbrojtur integritetin territorial dhe sovranitetin”, në të vërtetë, po u hapej rruga zhvillimeve që do të çojnë te bisedimet rreth një marrëveshjeje për paqe, me të cilën duhej të përfilleshin edhe kërkesat “konstruktive” të shqiptarëve. Si të tilla merreshin ato që lidheshin me reformat kushtetuese si dhe ndryshimet tjera të karakterit të barazisë, me të cilat shqiptarët përfaqësoheshin në përputhje me strukturën popullore në të gjitha institucionet shtetërore dhe sidomos në ato të policisë, gjyqësorit dhe të armatës, ku ata përfaqësoheshin simbolikisht.

Diskursi i “reformave” kushtetuese dhe te një raporti të ri demokratik rreth organizimit shtetëror, që do t'ua mbyllte dyert konflikteve të ngjashme, iu bë i ditur zyrtarëve maqedonas qysh në takimin e dy prillit me sekretarin gjeneral të NATO-s, Robertson bashkë me ambasadorët e Këshillit Veriatlantik në Shkup. Në konferencën e përbashkët për shtyp me kryetarin Trajkovski, Robertson, gjuhën ushtarake rreth “izolimit të ekstremistëve në Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë”, për pak e zëvendësoi me atë se “tërheqja e ekstremistëve (nuk i quajti terro-

---

<sup>2116</sup> Ostreni, Gëzim: “*Ushtria Çlirimtare Kombëtare*”, Dibër, 2014, faqe 188-189.

ristë), duhet zëvendësuar me atë të dialogut”, për të shtuar se “paqja në Maqedoni duhet të vendoset me anën e reformave kushtetuese dhe barazisë së plotë”.<sup>2117</sup>

Rituali i “mbështetjes së sovranitetit, integritetit territorial dhe pacenueshmëria e kufijve të Maqedonisë”, që për udhëheqësit maqedonas sikur kishte filluar të kthehej në një trysni të ndryshimeve të pashmangshme me të cilat parashihej një Maqedoni tjetër, jo më me preambulën e shtetit kombëtar maqedonas, u përsërit edhe dy ditë më vonë, në Konferencën e ministrave për mbrojtje të 13 vendeve të shteteve të Europës Juglindore në Shkup. Edhe aty, nga përshtypja se Maqedonia nuk ishte në gjendje që t’i jepte përgjigje ushtarake konfliktit, u theksua domosdoja e dialogut që duhej të përfundonte me një marrëveshje paqësore.<sup>2118</sup>

Që Maqedonia të joshej “për reforma” dhe njëherësh të fitohej përshtypja se kishte mbështetjen unanime “për mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial”, sado që UÇK-ja tashmë e pranonte atë dhe nuk kishte nevojë për kurrfarë garancionesh nga jashtë, kjo u pasqyrua me ceremoninë me rastin e asociimit të Maqedonisë në Bashkimin Europian, më 9 prill, ndonëse ky demonstrim mund të mbetej vetëm fjalë e shkruar në letër, po qe se nëpër vijat e fronteve do të vazhdonin luftimet deri më 15 maj, siç do të mbesin edhe për pak kohë në të vërtetë.

Sidoqoftë, bashkësia ndërkombëtare po i afrohej pikës kur edhe formalisht do t’u çasej kërkesave të UÇK-së, ndonëse përfaqësuesit e saj mund të mos ishin pjesë formale e tryezës së bisedimeve dhe të marrëveshjes së pashmangshme dhe se kjo pikë duhej të niste nga ndryshimi i Kushtetutës, nga preambula, ku përkufizimi i shtetit-komb duhej të hiqej. Për t’u zëvendësuar kishte vetëm dy alternativa: atë të shtetit me dy kombe (maqedono-shqiptar ose shqiptaro-maqedon), siç dilte nga Komunikata numër 6 e UÇK-së, ose të shtetit multietnik (shumë kombesh), siç kishte filluar të pëshpëritej nëpër kuluaret diplomatike dhe ato të zyrave ndërkombëtare nga Nju Jorku e deri në Bruksel.

Propozimi i dytë, mbi parimin multietnik (shumë kombesh) të qytetarisë, ishte fare i mundshëm dhe më real, ngaqë zbuste po edhe zhvlerësonte dy ekstremet, atë në fuqi të maqedonasve për *shtetin-komb* dhe të shqiptarëve - *për shtetin e të dy popujve*.

Në të vërtetë, pranimi i kompromisit, shfaqej me vështirësi të dyanshme. Në njërën anë - për maqedonasit të cilët për dhjetë vjet kishin jetuar dhe vepruar mbi bazat e shtetit kombëtar, dhe kjo përjetohej si heqje dorë nga një e arritur historike nga diktati i luftës së shqiptarëve, me çka fitohej përshtypja se u hapej

---

<sup>2117</sup>“Fakti”, 3 prill 2001.

<sup>2118</sup>“Fakti”, më 6 prill 2001.

rruga edhe lëshimeve të tjera të kësaj natyre. Dhe, në tjetrën anë - për ndër-kombëtarët, të cilët, po ashtu, për dhjetë vjet kishin pranuar dhe përkrahur një shtet mbi parime të gabueshme të shtetit-komb, që nuk ishte pranuar nga shqiptarët, shtet ky që e kishin lavdëruar dhe shpërblyer në mënyra të ndryshme edhe atëherë kur shihej haptas se forcën e demokracisë po e shfrytëzonte për të diskriminuar shqiptarët në të gjitha aspektet, gjë që nënkuptonte edhe përgjegjësinë ndërkombëtare ndaj një gabimi të qëllimshëm, që kishte sjellë edhe deri te lufta.

Sidoqoftë, maqedonasit tashmë e kishin të qartë se duhej të lëshonin pe, pra të pranonin shtetin dy-kombesh (federalizimin), ose variantin multietnik. Siç e kishin të qartë edhe luftëtarët shqiptarë se kushtetuta e Maqedonisë do të ndryshohej, se duhej të binte formulimi i shtetit kombëtar maqedonas, por nuk do të ketë as shtet federal mbi parimin dy-kombesh, me çka, edhe ata, në fund të fundit, do të ballafaqoheshin me përgjegjësinë se çfarë u fitua nga një luftë territorësh, që të kthen te shteti multietnik?

Qe këto kompromise, ose siç quheshin, reforma, të dukeshin të pranueshme për të gjithë, sidomos për maqedonasit, që i kishin hyrë një pune, që kishin mbetur në të dhe duhej të zmbropseshin dhe madje këtë ta bënin nën diktatin e armëve të shqiptarëve, me çka ngarkoheshin edhe me hipotekën e fajësisë historike të mosfuqisë për ta mbrojtur shtetin që u erdhi peshqesh nga shpërbërja e ish Jugosllavisë, do të përkujdesen amerikanët, si “sponsores” të shtetit maqedonas, po edhe mbështetës të shqiptarëve në Kosovë, të cilëve u kishin ndihmuar të çliroheshin nga Beogradi. Me vizitat në nivelet më të larta të zyrtarëve të tyre në Shkup si dhe pritjen e tyre (kryetarit Trajkovski) në Uashington, amerikanët po demonstرونin përkushtimin ndaj asaj që kishin fituar në rajon, me ç’rast u bëhej me dije të dy popujve se mospajtimet dhe konfliktet mes tyre, nuk mund të ndryshonin këtë fakt. Ndaj, ishin ata që do ta thoshin fjalën e fundit.

Kështu, randevu-ja e zyrtarëve të lartë amerikan si dhe atyre maqedonas në relacionet Uashington-Shkup dhe anasjelltas, nisi me vizitën e sekretarit amerikan të shtetit, Kolin Pauell në Shkup, më 12 prill. Sekretari amerikan i shtetit, pas takimit me Trajkovskin, Georgievskin dhe liderët e partive politike, në konferencën për shtyp i tregoi kornizat e dialogut të ardhshëm: reformat kushtetuese dhe bashkëjetesa, që nënkuptonte barazinë.

Ndonëse, dialogu nuk kishte filluar, Pauell lavdëroi “vullnetin për bashkëjetesë dhe dialog” me çka rrahu telin aty ku pritej. Ndërsa, i qartë ishte edhe sa i përket angazhimit dhe mbetjes së SHBA-ve në Ballkan, me ato që tha se “nuk ka

plan për tërheqjen e trupave amerikane nga Ballkani”, dhe se “mund të jeni të sigurt në angazhimin tonë për mbështetjen politike, ekonomike dhe ushtarake”.<sup>2119</sup>

Atë që në të vërtetë tashmë po e thoshin zyrtarët e niveleve të larta amerikane në bisedat e tyre “të mbyllura” me zyrtarët maqedonas, e thanë haptas disa kongresistë amerikanë, në krye me Eliot L. Engël, në një letër drejtuar kryetarit Trajkovski. Ajo fillonte me shfaqjen e shqetësimit në lidhje me situatën në vendin. Trajkovskit i bëhej me dije se “duhet përgjigjur shqetësimeve të qytetarëve shqiptarë të Maqedonisë, që tashmë janë të njohura, nga problemi i gjuhës i deklaruar në Kushtetutën tuaj që mohon gjuhën shqipe si gjuhë kombëtare, minimumet e përfshirjes së shqiptarëve në Parlament, përfaqësim i ulët në punësim, në administratë dhe financimi i universitetit të shqiptarëve atje”.<sup>2120</sup>

Letra e kongresistëve amerikanë përfundonte me sugjerimin e ndërprerjes së dhunës, si dhe gatishmërisë së qeverisë për t’u ulur me përfaqësuesit politikë shqiptarë për t’i shqyrtuar që të gjitha kërkesat e tyre që kanë sjellë krizën e fundit.

Karta e dialogut me shqiptarët, pra bisedimet për t’u ndryshuar gjendja dhe assesi “bisedime për bisedime” siç përgjigjej qeveria maqedonase kur hapej çështja e ndryshimeve kushtetuese, tashmë ishte hapur në atë mënyrë që ajo ngarkohej me përgjegjësinë pse kishte ardhur deri te kjo gjendje. Në njëfarë mënyre, këto e theksoi edhe ministri i jashtëm gjerman, Joshka Fisher, në Tiranë. Porosia e tij ishte e qartë drejtuar Shkupit se “Shqiptarët kudo ku janë nuk duhet të trajtohen si qytetarë të dorës së dytë. Ata duhet të kenë të drejtat të barabarta si të gjithë qytetarët evropianë”,<sup>2121</sup> njëhërsh shtetin maqedon e ngarkonte me fajësi për gjendjen e krijuar. Ishte ky, prononcimi i parë i kësaj natyre, ku gjermanët shfaqeshin kritik ndaj Shkupit zyrtar.

I kësaj natyre, do të jetë edhe vlerësimi i “Grupit Ndërkombëtar të Krizave për Maqedoninë”, me rastin e shpalljes së qëndrimit rreth krizës së Maqedonisë dhe shpërthimit të saj në konflikt të armatosur. Grupi Ndërkombëtar i Krizave për Maqedoninë me këtë rast shprehet kritik si ndaj Maqedonisë, që shqiptarët i ka diskriminuar çastin që shteti maqedonas është shpallur mbi parimin *shtet-komb*. Po ashtu, Grupi Ndërkombëtar i Krizave, u shfaq kritik edhe ndaj bashkësisë ndërkombëtare, që e kishte pranuar këtë. Andaj, Grupi Ndërkombëtar i Krizave për Maqedoninë, në mënyrë kategorike, kërkoi që preambula problematike e Kushtetutës doemos duhet të fshihet si dhe referencat tjera diskriminuese, me

---

<sup>2119</sup> “Fakti”, më 13 prill 2001.

<sup>2120</sup> Po aty.

<sup>2121</sup> “Fakti”, më 15 prill 2001.

çka ndryshohej edhe karakteri i shtetit-komb në atë qytetar, me kusht që me të të pajtoheshin edhe shqiptarët. Po ashtu, u kërkua edhe regjistrimi i përgjithshëm i popullatës me qëllim të përcaktimit sa më të saktë të realitetit demografik.<sup>2122</sup>

Me këtë rast Grupi Ndërkombëtar i Krizave për Maqedoninë ngriti pyetjen genësore rreth asaj se a janë maqedonasit dhe shqiptarët të bindur për bashkëjetesë? Apo, duhet ata të pranojnë një logjikë nacionaliste dhe të përgatiten të bisedojnë për federalizëm?<sup>2123</sup>

Ajo që megjithatë, paraqet një kthesë cilësore në qëndrimin e bashkësisë ndërkombëtare rreth krizës në Maqedoni drejt trajtimit të kërkesave që kishte shfaqur UÇK-ja me rastin e kapjes së armëve, me çka me atë që mund të quhet diplomaci proaktive fillon qasja kritike ndaj shtetit maqedonas në raport me shqiptarët si dhe katalogu i kërkesave drejtuar Shkupit zyrtar rreth zgjidhjes së krizës, lidhet me Rezolutën 9020 të Këshillit të Europës. Në amendamentet 4, 24 dhe 26 përcaktohet kornizat e dialogut në Maqedoni, ku duhet të përfshihen Reforma kushtetuese, të cilat do të bëheshin në drejtim të plotësimin të kërkesave të shqiptarëve, me ç'rast multiethniciteti i Maqedonisë duhet të përcaktojë edhe karakterin e shtetit multiethnic.<sup>2124</sup>

Doli se çështja e ndryshimit të preambulës së Kushtetutës së Maqedonisë si dhe ndryshimi i karakterit nga *shtetit-komb* në *shtet demokratik-multiethnic*, si zgjidhje e vetme me të cilën mund të ruhej Maqedonia nga erozioni i brendshëm por edhe nga sfidat e jashtme, kishte filluar të preokuponte edhe diplomacinë amerikane si dhe qarqet më të larta zyrtare të Uashingtonit, që tashmë ishin përcaktuar për këtë ndryshim, të cilit duhej krijuar mbështetja.

Kjo u pa edhe gjatë vizitës së kryetarit Trajkovski në Uashington, kur ai u mundua që bisedat e hapura ditë më parë në Shkup me sekretarin shtetëror amerikan Pauell rreth ndryshimit të preambulës së Kushtetutës së Maqedonisë (heqja e përcaktimit të Maqedonisë shtet kombëtar i maqedonasve), se ato ndryshojnë identitetin e maqedonasve, gjë që mund të nxiste reagimet e maqedonasve, me çka “qetësimi i një krize” krijonte rrethana “për hapjen e një krize tjetër më të madhe”, e arsytetime të ngjashme, që nuk u pranua nga sekretari amerikan i shtetit.

Përballë këtyre qëndrimeve, të cilat Uashingtoni zyrtar i shihte të domosdoshme që kriza në Maqedoni të mbahej nën mbikëqyrje e me të shpëtohej edhe

---

<sup>2122</sup> Ostreni, Gëzim: “*Ushtria Çlirimtare Kombëtare*”, Dibër, 2014, faqe 366.

<sup>2123</sup> Po aty.

<sup>2124</sup> “*Fakti*”, 26 prill 2001.

shteti maqedonas si interes amerikan, kryetari Trajkovski u dorëzua. Pranoi se Kushtetuta duhet të jetë pjesë e diskutimeve, dhe po ashtu, pranoi se pas ndihmës që iu dha Universitetit të Tetovës (10 milionë dollarë), ai do të zyrtarizohej.<sup>2125</sup>

### Aspekti politik i luftës – nga shteti dy kombësh te shteti multietik

Qëndrimet amerikane si dhe binarët që përcaktoi (ndryshimet kushtetuese me të cilat ndryshon karakteri i shtetit-komb në shtet-multietik si dhe çështjet tjera të reformave demokratike me të cilat sigurohet barazia institucionale e të gjithë qytetarëve), ndikuan dukshëm që edhe mekanizmat tjerë ndërkombëtarë, të pranojnë këta binarë. Mbi ta zu të operojë edhe OSBE-ja, me detyrën që në të përshinte faktorët politikë shqiptarë në Maqedoni dhe, indirekt, nëpërmes tyre edhe UÇK-në, po edhe faktorët politikë në Kosovë dhe në Shqipëri, në mënyrë që të shfrytëzohej ndikimi i tyre për arritjen e një marrëveshje me të cilën do t'i jepej fund krizës së Maqedonisë.

Te kjo pikë fillon edhe aspekti politik i luftës së UÇK-së, si mjet për të arritur qëllimet e caktuara politike, të cilat duhej të shpallehin dhe të ishin në përputhje me demonstrimin e fuqisë luftarake dhe parametrat e saj. Nëse me luftë, UÇK-ja ia kishte dalë që brenda një kohe të shkurtër ta tregojë si *shkaktar krize parimin shtet-komb*, mbi të cilin ishte shpallur shteti maqedonas pa mbështetjen e shqiptarëve, me çka faktori ndërkombëtar kishte treguar gatishmëri që shtetit maqedonas t'i ndryshohet edhe karakteri kombëtar në një shtet të qytetarëve, megjithatë UÇK-së, pos përshkrimit të shkaktarëve të krizës si dhe kërkesës së eliminimit të tyre, i kishte munguar një platformë e qëndrueshme politike me të cilën shqiptarët duhej të lidhnin një kontratë të re me maqedonasit për shtetin e përbashkët në përputhje me interesat e tyre strategjike, kontratë kjo që në rrethanat e krijuara duhej të mbështetej dhe të garantohej edhe nga faktori ndërkombëtar.

Përkundrazi, bie në sy se brenda tre muajve qëndrimet e UÇK-së kishin ndryshuar në kahun e tatëpjetës: nga ai i luftës çlirimtare kombëtare – që ishte iluzor, te opsioni për shtetin federal të dy popujve për të zbritur te opsioni i barazisë – që ishte real, te shteti multietik – për ç'gjë nuk kishte nevojë të luftohej.<sup>2126</sup>

Ndonëse opsioni i luftës çlirimtare kombëtare, me akronimin “UÇK”, asocionte me atë të “Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës” (UÇK) dhe, siç kishte ndodhur edhe me rastin e luftës së Kosovës, shpejt do të braktiset, ai megjithatë kishte paraqitur më tepër një efekt psikologjik, në formën e një kërcënimi, që nëse nuk

<sup>2125</sup> Ostreni, Gëzim: “Ushtria Çlirimtare Kombëtare”, Dibër, 2014, faqe 380.

<sup>2126</sup> Shih Amendamenti IV të „Службени весник на Република Македонија“, бр.91, 20.11.2001, Скопје.

përfillen kërkesat e shqiptarëve, atëherë kjo luftë do të ndiqte kahun çlirimtar. Këto pretendime ishin jo reale në rrethanat kur Kosova ishte vu nën protektoratin ndërkombëtar, ndërsa Shqipëria edhe më tutje vazhdonte të përpëllej në vorbullën e kaosit dhe nuk bënte për asgjë.

Edhe përkundër ruajtjes së akronimit “çlirimtare-kombëtare”, vetë UÇK-ja, tërhoqi nga opsioni “luftën çlirimtare kombëtare”, e me këtë edhe shkatërrimin e shteti maqedonas, për qëllime çlirimtare. Me kumtesën numër 6, të shpallur me 9 mars 2001, UÇK-ja konfirmonte integritetin territorial të Maqedonisë si dhe sovranitetin shtetëror. Madje, theksohej se “UÇK-ja nuk kishte filluar luftë kundër shtetit maqedonas, por për të drejtën e popullit shqiptar për të qenë pjesë e barabartë e tij”. Me këtë rast, fajësohej elita politike maqedonase e cila kishte degraduar shqiptarët në pakicë dhe ua kishte mohuar të drejtën historike dhe atë etnike që e kishin. UÇK-ja në këtë komunikatë theksonte kërkesën që shteti i Maqedonisë të ndryshojë kushtetutën nga ajo e kombit maqedonas në shtet dy kombesh: shqiptaro-maqedonas, gjegjësisht maqedonas-shqiptar.<sup>2127</sup>

Deklarimi për integritetin territorial të Maqedonisë si dhe sovranitetin shtetëror, gjithsesi se, në ato rrethana kur UÇK-ja po dëshmohej si faktor i fuqishëm ushtarak, padyshim se paraqet një fitore diplomatike dhe politike të UÇK-së, që do t’ia rrënojë Maqedonisë konceptin e shteti nacional mbi të cilin ishte ndërtuar si shtet në vitin 1991.

Por, kur pritej që kjo kërkesë të sforcohej dhe të materializohej me “kapitalin” e territoreve si fakt të kryer, ndodhi që me Platformën e 14 qershorit, UÇK-ja njëherësh hoqi dorë edhe nga opsioni për shtetin maqedonas dy-kombesh, që shfaqej si kërkesë në Kumtesën numër 6. Kjo tërheqje e papritur, që asnjëherë nuk u arsyetuar si duhet me çka me të drejtë ngre edhe çështjen e moskonsistencës së qëndrimeve politike dhe të faktorëve të mundshëm që e kanë ndikuar nga jashtë, do t’i hapë rrugën opsionit për shtetin multietnik në parim, siç do të dalë nga Marrëveshja e Ohrit, por që në praktikë, nisur nga simbolika dhe gjuha maqedonase si gjuhë zyrtare, simbolet shtetërore dhe të tjerat, nuk do t’ia mohojë karakterin maqedonas, pos që do t’ia konfirmojë edhe “me mjetet e luftës”.

Mund të thuhet se këtu dhe te kjo çështje bien ndesh limitet midis optimumit ushtarak dhe minimumit politik në fazën vendimtare, nga shkakut se kapitali ushtarak që kishte arritur UÇK-ja brenda një kohe shumë të shkurtë si dhe pozicionet e saj të qëndrueshme në raport me forcat policore dhe ato ushtarake maqedonase,

---

<sup>2127</sup> Ostreni, Gëzim: “Ushria Çlirimtare Kombëtare”, Dibër, 2014, faqe 188.



që vetëm sa mund të forcoheshin, nuk u përcollën me kërkesat e duhura politike (federalizmi i Maqedonisë, ose kantonizimin e saj),<sup>2128</sup> me çka do të pengohej që opsioni i “barazisë qytetare” të kthehej në një kurth të demokracisë, siç do të ndodhë në të vërtetë.

Por, edhe opsioni i krijimit të shtetit dy-kombesh, siç parashihte Kumtesa numër 6 e 9 marsit, ishte tepër përgjithësues. I mungonte projekti politik i organizimit të shtetit dy-kombesh: ai i federalizmit, ose kantonizimit, që do të mund të sendërtohej me organizim konkret të pushteti vendor nëpër zonat ku kishte mbikëqyrje ushtarake, me çka del se lufta mbeti preokupim për territoret dhe jo të organizimit politik dhe institucional të shqiptarëve në to në përputhje me kërkesat e tyre.

Kjo çështje nxjerr në pah, në një rën anë dallimet midis faktorit politik shqiptar në procesin e konstituimit të shtetit maqedonas mbi parimin shtet-komb nga viti 1991 e këndeje rreth përgjigjes që duhej t’i jepej në mënyrë që të mos pranohet pozita e pakicës, që për alternativë kishte atë të popullit shtetndërtues, dhe në tjetrën anë, të hezitimit të faktorit ushtarak, që luftën si dhe rezultatet e saj t’i përdor që fillimisht në marrëveshje me faktorin politik shqiptar (siç ishte ajo e Prizrenit), dhe pastaj me faktorin politik maqedonas dhe me pjesëmarrjen e ndër-kombëtarëve *të imponojë një kontratë të re me maqedonasit rreth fizionomisë së shtetit të përbashkët mbi parimet e barazisë së plotë kombëtare*, pra të barazisë kushtetuese si faktor shtetformues, e sanksionuar në preambulën e kushtetutës dhe assesit të barazisë qytetare mbi kriteret e të drejtave dhe lirive elementare njerëzore në rrethanat e demokracisë parlamentare, e cila përherë varet nga raportet e shumicës.

Nëse shkurtimisht mund të thuhet se sjellja e faktorit shqiptar nga fillimet e parlamentarizmit në Maqedoni, në vitin 1990 si dhe të shpalljes së pavarësisë së Maqedonisë, në vitin 1991, nuk kanë qenë në përputhje me përgjegjësinë me të cilat i ngarkonin këto zhvillime historike edhe në rastet më drastike të diskriminimit të shqiptarëve në planin institucional, atë politik, ekonomik, arsimor dhe kulturor si dhe të ushtrimit të represionit shtetëror ndaj tyre kur ata kërkonin barazi qytetare në vend se çështjen ta kthenin te shkaktari i krizës - mohimi i statusit të popullit shtetformues, kjo sjellje e papërgjegjshme e tyre do të përsëritet edhe nga shpërthimi i konflikteve të armatosura e këndeje. Qoftë kur nuk do të kuptohet drejt rëndësia e saj, duke iu bashkuar propagandës së shtetit maqedonas

---

<sup>2128</sup> Pettifer, James: “*Ushtria Çlirimtare e Kosovës*”, Tiranë, 2013, faqe 279.

për ta parandaluar dhe diskredituar atë në të gjitha mënyrat, qoftë edhe kur do të fillojë të kuptojë realitetet se ajo luftë, në mos për tjetër, duhej të paraqiste fundin e konceptit të shtetit-komb mbi të cilën ishte shpallur pavarësia e Maqedonisë. Kështu që përmbysja e konceptit shtet-komb, që shfaqej e pashmangshëm, nuk u përçoll me një platformë për federalizim, ose kantonizim të shteti të Maqedonisë, që si kusht do ta kishte, pikërisht, harmonizimin me faktorin luftarak rreth organizimit politik të strukturave autonome (federale ose konfederate) në territoret e mbikëqyrura nga UÇK-ja, me çka faktet e kryera me luftë, do të materializohejshin politikisht, për arritjen e federalizimit ose të kantonizimit të Maqedonisë.

Opsioni i organizimit të shtetit maqedonas sipas modelit të federalizimit ose kantonizimit, nuk ishte çështje tabu e as me anatemën e “rrënuesit të shtetit”, që vinte vetëm nga pala shqiptare dhe “prapavija shqiptaromadhe”, siç thuhej shpesh për t’i demonizuar ata. Përkundrazi, shfaqja e një modeli politikisht përjashtues, ngaqë në vend të federalizimit ose kantonizimit parashihte ndarjen e Maqedonisë si dhe këmbimin e popullsisë, doli po ato ditë edhe nga Akademia Maqedonase e Shkencave.<sup>2129</sup>

Projekti i Akademisë Maqedonase të Shkencave, i cili parashihte ndarjen e Maqedonisë me anën e dy komunave, që do t’i jepeshin Shqipërisë (Dibrës dhe Gostivarit) në shkëmbim me disa territore të Shqipërisë që do t’i jepeshin Maqedonisë, ndonëse pëshpëritej moti, megjithatë doli si i kurdisur për t’iu kundërvënë opsionit të UÇK-së rreth organizimit të Maqedonisë mbi parimin e dykombeve të barabarta: shqiptaro-maqedonas, gjegjësisht maqedono-shqiptar, pra të një shteti federal. Bisedimet që u zhvilluan me atë rast si në Akademinë Maqedonasetë Shkencave të politikanëve maqedonas me kryetarin Gjorgji Efremov më 30 maj 2001 si dhe të ngjashmëve në pjesë të tjera të vendit, kishin për qëllim që të hapin një çështje (atë të shkëmbimit të territoreve), që e kishin iniciuar akademikët serbë, për t’i justifikuar pretendimet e tyre hegjemoniste ndaj popujve të tjerë (kroatëve, boshnjakëve dhe shqiptarëve), të cilat, pas ndërhyrjes ushtarake të NATO-s në Kosovë në vitin 1999 dhe futjes së Kosovës nën protektorat ndër-kombëtar, kishin rënë në ujë.

Edhe pse ishte absurde që ideja për shkëmbim territorësh t’i adresohet Shqipërisë, kur shqiptarët etnikë të Maqedonisë historikisht dhe politikisht, së paku nga mesjeta e vonshme, ishin të lidhur me Kosovën dhe problematikën e saj, me Shkupin kryeqendër të tyre historike, megjithatë, ajo spostohej si e tillë, në rretha-

---

<sup>2129</sup> Ostreni, Gëzim: “Ushria Çlirimtare Kombëtare”, Dibër, 2014, faqe 510-514.

nat kur UÇK-ja ia kishte dalë që me luftën e shpejtë (vënia nën mbikëqyrje të mbi një të tretës së territorit të vendit), pikërisht të demonizohej mundësia e organizimit autonom të shqiptarëve në territoret e mbikëqyrra nga UÇK-ja, të cilat do të mund të shfaqeshin si pjesë e opsionit të organizimit të ri shtetëror të Maqedonisë mbi këto realitete autonome, siç kishte ndodhur edhe me atë të Republikës Serbe në Bosnje dhe Hercegovinë e të ngjashme, të cilat, nuk i përjashtonte as plani i Vensit dhe Ovenit, i propozuar nga Konferencën e Londrës, në vitin 1992.

Pavarësisht projektit të akademikëve maqedonas për ndarjen e Maqedonisë si dhe këmbimin e popullatës, që i shërbeu politikës maqedonase për të anatemuar e UÇK-së rreth shtetit dy-kombesh (shqiptaro-maqedonas, gjegjësisht maqedon-shqiptar), si dhe konfuzionit që duhej të përhapje në drejtim të Shqipërisë, Kosovës, Bullgarisë, Serbisë si dhe Greqisë, që edhe ato të përfshiheshin në “ku-lačin” e ri maqedonas, megjithatë kërkesa për organizim politik territorial, e cila mungoi fare, me siguri se do të mund të shfrytëzohej si një kartë tepër e fuqishme në bisedimet e ardhshme politike rreth organizimit të ri të shtetit të përbashkët, por të barabartë, për të cilin së paku formalisht, nga 9 marsi angazhohej edhe UÇK-ja.

Në vend të kësaj, faktori politik, i cili merrte pjesë në qeverinë e Georgijevskit (Arben Xhaferi me partinë e tij dhe të tjerët përreth), në mbështetje të ndryshimeve kushtetuese dhe me kërkesën e refrenit të barazisë formale mbi platformën e “barazisë qytetare”, e cila i kishte sjellë në atë gjendje, derdhte ujë vetëm në opsionin e shtetit demokratik-multietnik. Ndërsa, faktori ushtarak i UÇK-së, në vend se opsionin e shtetit dy-kombesh, siç kërkonte në Kumtesën numër 6, ta përcillte edhe me anën e organizimit konkret të pushtetit autonom vendor në territoret që mbikëqyrte, sa më shumë që forcohej territorialisht, e shoqëronte me retorikën për barazi, ku secili komunitet të jetë i lirë, përfshirë këtu edhe përdorimin e simboleve të veta kombëtare, e të ngjashme që u takojnë të drejtave elementare njerëzore dhe atyre qytetare, me çka krijonte rrethana që ndryshimet kushtetuese si dhe riorganizimi i shtetit maqedonas të shkonte drejt modelit multi-etnik. Kjo doli edhe nga Memorandumi i UÇK-së, nga 24 prilli 2001, që iu drejtua faktorit ndërkombëtar.<sup>2130</sup>

---

<sup>2130</sup> Shih Memorandumin e UÇK-së, më 24 prill 2001. Përfaqësuesi politik i UÇK-së, Ali Ahmeti, duke dëshiruar t'i bëjë të ditura arsyet e luftës së UÇK-së, në emër të saj shpalli një memorandum, të cilin ua dërgoi Kofi Annan-it, Lordit Xhorxh Robertson, Romano Prodit (kryetar i Komisionit Evropian) dhe Guemanu Mirçe (kryetar i OSBE-së), thotë se “*kemi marrë armët që të luftojmë për në radhët e UÇK-së për liri, drejtësi dhe barazi*”. Ahmeti, po ashtu, siguron se “*nuk kemi kurrë arsye të shkatërrojme Maqedoninë. UÇK-ja është përcaktuar për ruajtjen e integritetit territorial dhe sovranitetit të Maqedonisë.*” Dhe, “*për ne është e*

Kjo madje, u pa edhe në “Qëndrimet e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së për mbështetjen e paqes”, të shpallura me rastin e organizimit të samitit për Planin e Paqes të Trajkovskit, në të cilin, partitë politike shqiptare dolën me Projektplanin për ndryshime që duhet të bëhen në bazë të kërkesave të UÇK-së të parashtruara si kushte për demokratizimin e Maqedonisë qysh nga Komunikata 6.<sup>2131</sup>

Në këtë komunikatë, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, përfundimisht e braktisi opsionin e federalizmit të Maqedonisë në *shtet dy-kombesh*, duke mbështetur modelin e *shtetit multi-etnik*, i cili do të arrihej me anën e ndryshimeve Kushtetuese dhe të demokratizimit. Me këtë rast UÇK-ja, nga pikëpamja politike u dha vule tri çështjeve, të cilat janë kompetenca të proceseve demokratike dhe të reformave brenda saj dhe assesi luftës, të cilat do ta përcaktojnë marrëveshjen e paqes mbi parimet:

- se reformat, për të cilat angazhohen shqiptarët, kanë për qëllim ruajtjen e integritetit territorial dhe karakterin multi-etnik të Maqedonisë;

- se nuk ka zgjidhje etnike territoriale për problemet në Republikën e Maqedonisë dhe se çdo përpjekje për ta copëtuar etnikisht territorin, u sjell dëm vetë qytetarëve të Maqedonisë dhe paqes në rajon dhe

- se nuk ka zgjidhje ushtarake për problemet në Republikën e Maqedonisë.<sup>2132</sup>

Modeli i shtetit multi-etnik, i treti me radhë, ku UÇK-ja, brenda katër muajsh përfundimisht ishte ndalur, kishte pajtuar por edhe bashkuar faktorin politik shqiptar (subjektet politike të përfshira në jetën institucionale dhe parlamentare të vendit nga shpallja e pavarësisë në vitin 1991) me faktorin ushtarak shqiptar të përfshirë në strukturat komanduese-ushtarake të UÇK-së jashtë ndonjë platforme me të cilën lufta e shqiptarëve do të ndryshonte esencialisht pozitën e tyre, për ç’gjë ajo edhe kishte filluar.

Ky pajtim, në të vërtetë, kishte nxjerrë në pah paralojën e ndryshimit të roleve të këtyre faktorëve në jetën politike të vendit, me ç’rast akterët e deridjeshëm të jetës institucionale dhe parlamentare do të zëvendësohen nga komandantët e

---

*parëndësishme se si do të quhej ajo: maqedono-shqiptare apo shqiptaro-Maqedonase. Ajo që është e rëndësishme është se Maqedonia nuk mund të vazhdojë të jetë një pronë e një entiteti, në të cilën shqiptarët jetojnë nën segregacion vetëm për shkak se janë të tillë – shqiptarë. Ne kërkojmë që Kushtetuta të ndryshohet, kështu që së bashku me gjuhën Maqedonase edhe gjuha shqipe të bëhet gjuhë zyrtare. Gjithashtu, ne kërkojmë që secili komunitet të jetojë i lirë, që t’i përdor simbole e veta kombëtare.” (Shih: Ostreni, Gëzim: “Ushtria Çlirimtare Kombëtare”, Dibër, 2014, faqe 375-377)*

<sup>2131</sup> Projekt-Plani paqësor i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, me kërkesa iu drejtua NATO-s më 14 qershor 2001.

<sup>2132</sup> Shih: Qëndrimet e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së për mbështetjen e paqes te Ostreni, Gëzim: “Ushtria Çlirimtare e Kombëtare”, Dibër, 2014, faqe 589-590).

luftës, por që ky ndryshim kishte ardhur në një mënyrë “të tërthortë” në rrethanat kur subjektet politike kishin shërbyer si ndërmjetës midis faktorit politik maqedonas dhe atij ndërkombëtar, i cili kishte menaxhuar gjithë procesin e bisedimeve deri tek marrëveshjet e Ohrit.

## MARRËVESHJA E PRIZRENIT–SUKSESIN E LUFTËS E KTHEU NËKOMPROMIS POLITIK

Rruga e bisedimeve “ndërmjetëse” midis subjekteve politike maqedonase që kishin përfaqësuar institucionet shtetërore dhe ato parlamentare dhe liderëve ushtarakë të UÇK-së, që kishin folur në emër të “Shtabit të Përgjithshëm”, kishte kaluar nëpër një marrëveshje politike që ishte arritur në Prizren. Me këtë marrëveshje, UÇK-ja do të bëhet pjesë e procesit politik, për ç’gjë ishin angazhuar faktorët meritore ndërkombëtarë. Por, duhet thënë se përfshirjen e UÇK-së në procesin politik, ndonëse me naze, e kishin dëshiruar edhe maqedonasit, të cilët e dinin se ishte shtabi i Tetovës ai që duhej ta thoshte fjalën e fundit, fjalë kjo që sipas Komunikatës 6 të marsit, kur mbrohej integriteti territorial dhe ai shtetëror i Maqedonisë dhe Projekt-Planit të Paqes së UÇK-së të 14 qershorit, në kuadër të reformave kushtetuese kërkohesh shteti multietnik, për maqedonasit ishte e mirëseardhur, ngaqë me anën e tyre, edhe më tutje do t’i ruanin pozitat dominuese në institucionet e vendit. Ndërsa pozita e shqiptarëve, paçka se kishin luftuar, mund të ndryshohesh paksa, por jo që të arrinin te limitet, ngaqë vetë karakteri i demokracisë me fuqinë e shumicës, pengon këtë.

Sidoqoftë, marrëveshja e Prizrenit, duhej t’ia hapte rrugën një zgjidhje politike për të cilën ishin pajtuar që të gjithë, që do të arrihej me palën shqiptare me anën e një marrëveshje për ndërprerjen e armiqësive (luftës). Meqë këtë punë kishte marrë përsipër qeveria e koalicionit e zgjedhur më 15 maj, Trajkovski kishte kërkuar nga ndërmjetësuesi Robert Frowick, i emëruar i veçantë i OSBE-së për Maqedoninë, një “fushatë” për ndërprerjen e luftimeve të armatosura, që duhej të shkonte nëpërmes një marrëveshjeje të faktorëve politikë shqiptarë në rajon – në Maqedoni, Kosovë dhe Shqipëri me çka Maqedonia fitonte garanci “gjithëshqiptare” për opsionin e multietnicitetit në Maqedoni, që përjashtonte atë më të rrezikshmin për Shkupin – shtetin dy-kombesh, siç ishte kërkuar fillimisht nga UÇK-ja.

Marrëveshja e faktorëve politikë shqiptarë në rajon, atyre në Maqedoni dhe Shqipëri, për Frowickun si iniciues të saj dhe faktorin ndërkombëtar në përgjithë-

si nuk duhej të paraqiste ndonjë vështirësi. Edhe pse faktorët politikë shqiptarë vinin nga tri realitete të ndryshme politike dhe shtetërore dhe përkatësi të ndryshme intelektuale, megjithatë, pjesa më e madhe e tyre (ata nga Kosova dhe Maqedonia) kishin të përbashkët veprimtarinë në rrethanat e shpërbërjes së ish Jugosllavisë dhe angazhimin për çështjen e Kosovës në kuadër të rezistencës institucionale dhe të asaj të armatosur në radhët e luftës së UÇK-së, veprimtari kjo që në vitet e fundit (1989-1999), në shumë aspekte ishte zhvilluar në Shqipëri dhe e gjitha kishte kaluar nëpër një emancipim të përbashkët politik rreth asaj që shfaqej si interesa i përbashkët shqiptar në rrethanat e reja, e ku shteti maqedonas, edhe si interes i shqiptarëve, kishte mbështetje unanime.

Në këtë aspekt, për një pjesë të intelektualëve nga Maqedonia, të inkorporuar në strukturat e parlamentarizmit dhe ato institucionale të shtetit maqedonas (të pranuar ndërkombëtarisht nga Shqipëria), megjithatë, Tirana, kishte filluar të kthehej në një referencë të re të joshjes politike, ngaqë kësaj i ndihmonin edhe raportet shtetërore dhe ato institucionale Maqedoni-Shqipëri si dhe lidhjet që krijonin ato në planin shoqëror dhe politik të niveleve të lara, ndonëse Prishtina edhe më tutje mbetej një lidhje e pashkëputur intelektuale dhe shpirtërore.

Edhe Tirana kishte filluar të sillet ndaj realiteteve politike dhe shoqërore në Maqedoni në përputhje me interesat shtetërore dhe kjo pasqyrohej me prioritetet ndaj partnerëve shqiptarë nga skena politike e Maqedonisë, me ç'rast A. Xhaferi dhe partia e tij PDSH-ja, e cila Prishtinën, për shumëçka e kishte zëvendësuar me Tiranën, kishte dalë në plan të parë, ndërsa ishin mënjeluar lidhjet me PPD-në e N. Haliti me orientim prokosovar - mbështetëse e opsionit për autonomi politike dhe territoriale të shqiptarëve në Maqedoni e lidhur ngushtë me Kosovën, e anatemuar "si nacionaliste".<sup>2133</sup>

Krahas, A. Xhaferit, në Tiranë "rezidonte" edhe Ali Ahmeti, i vendosur atje nga koha e luftës së Kosovës, prej nga, brenda "Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së", merrej me "punë logjistike". Si militant i LPK-së (degës në Zvicër), Ali Ahmeti, bashkë me H. Thaçin, XH. Halitin dhe të tjerët, që i takonin këtij grupimi, kishte lidhje shumë të mira edhe me socialistët shqiptarë, me të cilët i lidhte afria ideologjike edhe gjatë kohës së regjimit komunist në Shqipëri. Pas ardhjes së so-

---

<sup>2133</sup> Ndaj Nevzat Halimit, kryetar i Parisë së Prosperitetit Demokratik, që nuk kishte përkrahur opsionin e shtetit-komb me të cilin Maqedonia kishte shpallur pavarësinë në vitin 1991, duke organizuar referendumin për autonomi politike dhe territoriale në janar 1992, ishin ndërmarrë masa ligjore. Sekretari organizativ dhe disa të tjerë u burgosën dhe u dënuan nën akuzën e "organizimit të kryengritjes së armatosur në Maqedoni".

cialistëve në pushtet, në vitin 1997, “trojka” e LPK-së, me “rezidencë” në Tiranë, kthehet në partner kryesor të qeveritarëve shqiptarë.<sup>2134</sup>

Vegëza politike e liderëve shqiptarë në trekëndëshin Tiranë-Prishtinë-Shkupit, në raport me Maqedoninë dhe rolin e shqiptarëve në arritjen e marrëveshjes paqësore atje duhej t’ua kthente “kohezionin e brendshëm”, siç kishte ndodhur edhe gjatë bisedimeve të Rambujesë në shkurt dhe mars 1999, gjithsesi se shfaqej Veton Surroi thuajse i pashmangshëm. Siç dihej, në skenën politike të Kosovës, Veton Surroi paraqitet nga fillimet e pluralizmit politik në vitin 1989, kur në Prishtinë bënte përpjekje të themelonte partinë projugosllave (UJDI), e cila kishte dështuar në saje të shfaqjes së “Lidhjes Demokratike të Kosovës”, përreth së cilës do të bashkohen pjesa më e madhe e shqiptarëve. Më vonë, Surroi, drejtoi “Partinë Parlamentare të Kosovës”- si një alternativë qytetare, të cilën, pas pak do t’ia dorëzojë Demaçit dhe përkrahësve të tij – oponentë të “Lidhjes Demokratike të Kosovës”. Nga partitë politike, Surroi, përqendrohet në gazetari. Themelon gazetën “Koha” e pak më vonë edhe Shtëpinë botuese me të njëjtin emër. Si botues i pavarur dhe me shkathtësi të dukshme intelektuale dhe elokuencë politike, Surroi mbetet referencë e faktorëve ndërkombëtar, nga shkaku i pikëpamjeve të tij që zgjidhja e çështjes së Kosovës duhej gjetur në bisedime me Beogradin në formën e ndonjë kompromisi, ku duhej të merrte pjesë edhe faktori ndërkombëtar.

Gjatë përshkallëzimit të konflikteve të armatosura në Kosovë, nga viti 1997 kur kishte dalë në skenë “Ushtria Çlirimtare e Kosovës”, Surroi “*faktorin luftë*” e kishte parë si mundësi, që lufta e deri atëhershme e diplomacisë ta kthehet në diplomaci të luftës, siç kishte ndodhur kur Grupi i Kontaktit kishte caktuar Konferencën e Rambujesë në Paris në shkurt të vitit 1999, ku edhe kishte marrë pjesë “si i pavarur” në kuadër të delegacionin shqiptar. Aty kishte shërbyer, së paku formalisht, si urë lidhëse midis krahut institucional (Rugovës) me atë të luftës (Thaçit), siç u kishte shërbyer edhe kontakteve të para të amerikanëve (Hollbrukut) me përfaqësuesit e UÇK-së në Junik në vitin 1998 bashkë me F. Aganin e LDK-së. Me këtë “imazh” kishte marrë pjesë edhe në nënshkrimin e dokumenteve të Rambujesë (bashkë me Thaçin, Rugovën dhe R. Qosjen). Kështu që, ndihma që

---

<sup>2134</sup> Më gjerësisht rreth portretit politik të Ali Ahmetit në kuadër të LPK-së, të UÇK-së si dhe “klanit” familjar (dajë-nip) me Fazli Velin dhe lidhjet e tyre me Maqedoninë, shih te Pettifer, James: “*Ushtria Çlirimtare Kosovës*”, Tiranë, 2013, faqe 271-277. Pettifer, shfaqjen e Ali Ahmetit në krye të UÇK-së së Maqedonisë e sheh si “*një fat të madh*”, meqë sipas biografit të UÇK-së sipas versionit të LPK-së, “*Ahmeti është njëri ndër politikanët më të shkathtë*” (faqe 272), që “*si lider i luftës në Maqedoni*” nga radhët e politikës kishte “*parnter*” A. Xhaferin “*e moderuar*” dhe një Rugove, siç ishte rasti me Thaçin në Kosovë, që “*pengoi krahun e luftës për ta imponuar opsionin e pavarësisë nga çastet e para*”.

Surroit i ishte kërkuar nga Robert Frowick për “një ndërmjetësim” midis Arben Xhaferit dhe Ali Ahmetit, bartësve kryesor të krahut politik dhe atij ushtarak të shqiptarëve të Maqedonisë, në njëfarë mënyre rikthente te pozicionet e ngjashme midis shqiptarëve të Kosovës në prag të Marrëveshjeve të Rambujesë, të cilët nxiteshin nga faktori ndërkombëtar (në radhë të parë ai amerikan) për bisedime dhe marrëveshjeje për t’u dhënë fund konflikteve luftarake në të cilat ishin përfshirë, me të vetmin ndryshim se Rambujesë ia hapte rrugën ndërhyrjes ushtarake të NATO-s kundër Millosheviqit në Kosovë, ndërsa marrëveshja e shqiptarëve me maqedonasit, rikthente paqen e lënduar në Maqedoni.

Frowick, këshilltari David Foley dhe ambasadori H. Ajf, më 16 maj arritën në Prishtinë dhe para se të takoheshin me Surroin, që t’i jepej besimi i ndërmjetësimit, Frowick dhe Foleyu takuan me Rugovën, Thaçin dhe Haradinajn dhe me komandantin e TMK-së, gjeneralin Agim Çeku. Bisedimet me këta të fundit, ishin të një peshe të veçantë, meqë Ali Ahmeti vinte nga strukturat e njëjta politike (LPK-ja) si dhe Thaçi, të katakuptuar nga “komisarët politikë” në “komisarë ushtarakë”. Ndërsa edhe “Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së”, gjenerali Gëzim Ostreni, me pedigrenë e aktivistit politik të LPK-së, vinte nga strukturat e larta të UÇK-së së Kosovës, i cili, mbas çmilitarizimit kishte qenë i përfshirë edhe në TMK-në, si komandant i një zone, prej nga edhe kishte kaluar në luftën e Maqedonisë bashkë me shumë ish luftëtarë nga lufta e Kosovës si dhe pjesëtarë të TMK-së.

Po ashtu, edhe një pjesë e mirë e luftëtarëve në radhët e brigadave të UÇK-së në Maqedoni ishin bashkëluftëtarë të Haradinajt, nga zona e Dukagjinit. Kështu që vetëm marrëveshja me ish komandantët e UÇK-së në Prishtinë do të thoshte njëherësh dritë e gjelbër për ndërprerjen e luftimeve në Maqedoni, paçka se asaj ia jepte rolin e stimuluesit të drejtpërdrejt të saj, siç e thoshte Shkupi zyrtar nga fillimet e luftimeve.<sup>2135</sup>

Kjo edhe ishte pritur pasi që UNMIK-u kishte kërkuar nga liderët kosovar nga krahu i luftës, që t’u ndalej shkuarja e bashkëluftëtarëve të tyre nga radhët e UÇK-së në Maqedoni, ndërsa atyre që ishin atje (Ostrenit dhe të tjerëve që vinin nga strukturat e TMK-së), t’u bëhej me dije që të përkrahnin marrëveshjet e paqes.

Pasi që të kishin marrë miratimin e liderëve kryesorë për mbështetjen e procesit të paqes në Maqedoni, që duhej të fillonte së shpejti, Frowick dhe shoqëruesit e tij ishin takuar edhe me Veton Surroin, botues i “Kohës Ditore”, i njohur edhe për lidhjet e mira që kishte me Arben Xhaferin, po edhe me një pjesë të ko-

---

<sup>2135</sup> Ostreni, Gëzim: “*Ushtria Çlirimtare e Kombëtare*”, Dibër, 2014, faqe 456.



mandantëve të UÇK-së, të cilëve u kishte dhënë mbështetje në gazetën “Koha ditore” gjatë luftës.

Surroi kishte pranuar të ndërmjetësonte me kusht që bisedimet të mos çonin te ndarja e Maqedonisë, meqë kjo ishte kundër bindjeve të tij.<sup>2136</sup>

Por, ky kusht as që i duhej, ngaqë, UÇK-ja, qysh në Komunikatën numër 6, kishte theksuar mbrojtjen e integritetit territorial si dhe sovranitetin shtetëror të Maqedonisë dhe gjithnjë e më shpesh theksonte reformat kushtetuese me anën e të cilave në shtetin multi-etnik realizohej barazia e plotë e të gjithëve.

Ideja për t’u takuar në Prizren nuk ishte e rastësishme. Kishte arsyet praktike-teknike (Ali Ahmeti mund të lëvizte lirisht nga shtabi i tij afër Tetovës për në Prizren, nëpër brezin deri te kufiri me Kosovën ngaqë e mbikëqyrnin forcat e tij) edhe pse ajo pjesë mbikëqyrje nga KFOR-i amerikan dhe britanik, por kishte edhe simbolikë historike, meqë Prizreni ishte qendra politike e nacionalizmit shqiptar, që kishte ushqyer të gjitha lëvizjet shqiptare për liri dhe pavarësi, që si e tillë nga shumëkush shihej edhe lufta e UÇK-së në Maqedoni. Andaj, marrëveshja shqip-tare në Prizren, pos pajtimit të brendshëm, dërgonte edhe mesazhe bashkimi jashtë, të cila edhe në këto rrethana kishin rëndësi të veçantë, që gjërave që quheshin “historike”, paçka se nuk ishin të tilla, t’ua jepte grimin e duhur “patriotik”. Nga ato që thotë Surroi në kujtimet e tij, Prizreni dhe simbolika e tij kishin paraqitur një shtysë motivuese për arritjen e marrëveshjes midis faktorit politik dhe atij ush-tarak shqiptar ngaqë vlerësonin se ndodheshin para një përgjegjësie historike.<sup>2137</sup>

Në të vërtetë gjatë takimit të parë me Ali Ahmetin në Prizren, Surroi thotë se kishte fituar përshtypjen se UÇK-ja po ashtu kërkonte mbylljen e konfliktit me anën e një marrëveshje të paqes, “duke kërkuar që ajo të bëhej pjesë e procesit politik në një negociatë dhe e vetmja mënyrë se si kjo mund të ndodhë është së bashku me partitë politike shqiptare”.<sup>2138</sup>

Siç pritej, Ali Ahmeti kishte disa kërkesa, të cilat duhej plotësuar për t’u filluar procesi politik. Ndër to ishte prania si dhe vendosja e trupave të NATO-s në Maqedoni, ngaqë shqiptarët kishin humbur besimin në demokracinë e njëanshme dhe të shpërdorur si dhe në aparatën policore dhe ushtarake të shtetit maqedonas, i cili kishte qenë në shërbim të represionit dhe dhunës kundër shqiptarëve, siç

---

<sup>2136</sup> Më gjerësisht rreth takimeve të Prizrenit me Ali Ahmetin dhe Arben Xhaferin në një furrë, shih librin e V. Surroit “*Libri i Fluturave*”, Prishtinë, 2011.

<sup>2137</sup> Surroi, Veton: “*Libri i Fluturave*”, Prishtinë, 2011, faqe.

<sup>2138</sup> Po aty, faqe 106.

ishite parë edhe gjatë konfliktit të fundit, kur pas dështimeve në vijat e fronteve, në shenjë hakmarrje, kishin sulmuar vendbanimet e shqiptarëve. Ndër këto kushte ishin edhe ato që lidheshin me demilitarizimin e Maqedonisë, amnesitimin e pjesëtarëve të UÇK-së si dhe disa të tjera të natyrës teknike.<sup>2139</sup>

Mbas takimit të parë me Ali Ahmetin në Prizren, Surroi kishte nxituar të takohej me Frowickun në Shkup për ta njoftuar rreth kërkesave të UÇK-së.

Kështu, kishte filluar ndërmjetësimi midis Ali Ahmetit dhe të dërguarit special, diplomatit amerikan Ferowicik dhe bashkëpunëtorëve tij. Ishte e natyrshme që njoftimet e dyanshme të sillleshin nëpër qarqe të larta dhe të përcillehin në të gjitha anët, veçmas në relacionet midis ndërmjetësuesit ndërkombëtar dhe qeveris maqedonase, e cila, ishte në pozitë, që “nga distanca” të informohej dhe njëherësh të hartonte strategjinë e ardhshme rreth bisedimeve të paqes që do të fillonin sapo të nënshkruhej marrëveshja e armëpushimit.<sup>2140</sup>

Në bisedën e dytë në Prizren, Surroi ia kishte përcjellë Ali Ahmetit qëndrimet e Frowickut, duke ia bërë me dije se dy prej tri objektivave mund të arrihen: fillimi i procesit politik, me kërkesat e ndërtuara edhe të UÇK-së si dhe ky proces të ndërlidhet me atë të amnestisë së ushtarëve të UÇK-së dhe të demilitarizimit të UÇK-së. Ajo çfarë duke se nuk mund të arrihet ishte vendosja e trupave të NATO-s në Maqedoni si forcë sigurie, pas së cilës do të fillonte procesi negociator,<sup>2141</sup> nga që dihej se një vendim i tillë, së pari kërkonte qëndrimin unanim të Asamblesë Veriatlantike, gjë që vështirë të arrihej, dhe së dyti, kërkonte edhe mandatin e KS të OKB-së, që varej nga qëndrimi i Ruisisë dhe Kinës aty.

Takimi i përbashkët i Surroit me Ali Ahmetin dhe Arben Xhaferin ishte mbajtur në furrën e Prizrenit, aty ku kishin filluar takimet e para. Surroi thekson se “qëllimi i takimit ishte unifikimi i qëndrimeve ndërmjet Aliut dhe Arbenit për të përgatitur një platformë për negociatën për përfundimin e luftës me realizimin e kërkesave të shqiptarëve, mapë-kornizë, që do të shprehte qëndrimet e UÇK-së dhe do të ishte konsensual për UÇK-në dhe partitë politike, dhe njëkohësisht një proces që do ta nxjerrë UÇK-në prej pozitës së tanishme të pamundshme për negociatat, te një ‘organizatë terroriste’ drejt një pozicionimi të legjitimitetit politik”.<sup>2142</sup>

Në takim u sollën edhe këto konkluzione:

-Shlyerja e preambulës së Kushtetutës;

---

<sup>2139</sup> Po aty.

<sup>2140</sup> Po aty.

<sup>2141</sup> Po aty.

<sup>2142</sup> Po aty.

- Përdorimi i pakufizuar i gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare në Maqedoni;
- Përfaqësimi përpjesëtimor etnik në institucionet e shtetit;
- Zgjerimi i kompetencave të komunave;
- Shekullarizimi i plotë i Kushtetutës së shtetit;
- Vendosja e demokracisë konsenzuale në fushat që kanë të bëjnë me të drejtat etnike; do me thënë, pengimi i mbivotimit mazhoritar në fushat që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me të drejtat etnike.

U vendos që vëmendje t'i kushtohet edhe amnistisë së përgjithshme për të gjithë të përfshirit në konfliktin e armatosur si dhe çështja e shërbimit ushtarak në ARM brenda territorit të komunës së vendlindjes.<sup>2143</sup>

Kërkesat që kishin dalë nga takimi i përbashkët midis Ali Ahmetit dhe Arben Xhaferit me Surroin, që do t'i dorëzohen në Shkup Frowickukt, nuk ishin të reja e as të panjohura. Si të tilla ato tashmë ishin shfaqur në Kumtesën numër 6 të UÇK-së, në Memorandumin e Ali Ahmetit drejtuar faktorit ndërkombëtar si dhe në prononcimet e ngjashme që vinin nga Shtabi i UÇK-së.

Në këtë pako, e re ishte vetëm kërkesa rreth përfshirjes së plotë të NATO-s në procesin e implementimit të paqes, që nënkuptonte edhe demilitarizimin e Maqedonisë, kërkesë kjo që ishte jo reale, megjithatë mund të përdorej për koordinata të tjera.

Frowick kërkoi nga UÇK-ja që me shkrim të operacionalizohen pikat e përmbajtjes, duke bërë me dije se me to mund të shkojë te Trajkovski për të filluar procesin e paqes dhe pajtohen që të kenë një tekst të shkurtër sapo ai të ketë biseduar me Trajkoskin.<sup>2144</sup>

Më 21 maj, Surroi ia dorëzon Frowickut, ofertat e shkruara nga lidershipi i UÇK-së të përmbledhura në shtatë pika:

1. Shpallja e përfundimit të operacioneve luftarake të UÇK-së dhe fillimi i dialogut në nivel politik përmes institucioneve të shtetit me lehtësim ndërkombëtar, të përcjellë me deklarata të ngjashme nga autoritetet maqedonase;
2. Shpallja e amnistisë (me afat përfundimtar prej një muaji) nga autoritetet maqedonase, me përjashtim të të dyshuarve dhe kryerësve të krimeve dhe të krimeve kundër njerëzimit;
3. Vendosja e menjëhershme e vëzhguesve të paarmatosur të OSBE-së (opsioni: të armatosur me revole) në rajonin kritik të Kumanovës (opsioni B: të gjitha zonat ku është luftuar, duke përfshirë edhe Tetovën);

<sup>2143</sup> Ostreni, Gëzim: "Ushtria Çlirimtare Kombëtare", Dibër, 2014, faqe 462.

<sup>2144</sup> Po aty, faqe 465.

4. Vendorsjen e pranisë së paarmatosur institucionale të shtetit maqedonas (pre-fekti i Likovës, institucionet shëndetësore etj.) në kohëzgjatje prej dy muajve, në mënyrë identike me qëndrimin e vëzhguesve të OSBE-së);
5. Dorëzimin e armëve të UÇK-së para komisionit të udhëhequr nga pushteti lokal i Likovës dhe OSBE-së, dhe me pas dorëzimin nga ana e OSBE-së deri te strukturat maqedonase të sigurisë;
6. Shpallja e deklaratës së përbashkët të liderëve politikë shqiptarë për qëllime të përbashkëta, të cilat duhet të arrihen me procesin reformues. Deklaratë e nënshkruar edhe nga Ali Ahmeti dhe
7. Shpallja nga an e kryetarit Trajkovski të datës së fillimit të negociatave për reformimin e Maqedonisë.

Kërkesat e përfaqësuesve shqiptarë, nga Frowicku do të revidohen dukshëm duke i zbrëthyer në njëfarë *plani aksional* thuajse njëanshëm, me të cilin do të merrej kryesisht qeveria maqedonase, ndërsa pala shqiptare, ndonëse pjesëmarrëse e konfliktit, mbete jashtë ndikimit. Kjo u pa edhe me refuzimin kategorik që Ali Ahmetit t'i përmendet emri në konkluzione si dhe pjesëmarrja e luftëtarëve në bisedime. Sipas Frowickut, luftëtarët shqiptarë mund të merrnin pjesë në bisedime, në kuadër të ndonjërit nga subjektet politike (PDSH ose PPD), vetëm pasi që UÇK-ja të pushojë me veprimet dhe të rehabilitohet,<sup>2145</sup> gjë që e gjitha lente përshtypjen e një marrëveshjeje për kapitullim.

Edhe sa u përket çështjeve të tjera, sidomos atyre që kanë të bëjë me reformat, Frowick, thuajse anashkalohej esenca e problemit, pra ndryshimi i preambulës së kushtetutës, me të cilën duhet të ndryshohet koncepti *shteti-komb* në *shtet të barabartë qytetar*. Me këtë rast, Frowick insiston që *në vend të ndryshimit të kushtetutës*, siç kërkojnë shqiptarët të ketë *reforma kushtetuese*, dhe ato të shkojnë në drejtim të barabarësisë së të drejtave individuale dhe qytetare dhe barabarësisë së përgjegjësisë individuale qytetare, si mundësi për mënjanimin e jostabilitetit kronik për shkak të refuzimit shqiptar, që të pranohet Kushtetuta e vitit 1991.<sup>2146</sup>

Edhe formulimi “jostabilitet kronik”, i parë nga këndvështrimi i “refuzimit të shqiptarëve që të pranohet Kushtetuta” nxjerr në pah “fajësinë” e shqiptarëve dhe jo shkaktarin kryesor – Kushtetutën që ata i diskriminon dhe rolin e hartuesve dhe miratuesve të saj – klasës së gjithëmbarshme politike maqedonase.

---

<sup>2145</sup> Po aty, faqe 466.

<sup>2146</sup> Po aty.

Përkundër përpjekjeve të Frowickut që bisedimet e Prizrenit me ndërmjetësimin e Surroit si dhe qëndrimet nga aty të “zbuteshin” sa më shumë, nuk do të pëlqehen nga pala maqedonase, e cila bisedimet e ardhshme i kushtëzonte me ndërprerjen e menjëhershme të luftimeve nga ana e UÇK-së si dhe dorëzimin e armëve. Kryetari Trajkovski ishte thujse kategorik në kërkesën e tij që të mos hiqet cilësimi “terroristë” për luftëtarët e UÇK-së si dhe të përjashtohet çfarëdo pjesëmarrje e Ali Ahmetit në bisedimet e ardhshme. Trajkovski, po ashtu, kërkonte nga Frowicku që UÇK-së t’i jepej një afat prej disa ditësh t’i pranojë kërkesat (ultimative), ose t’i nënshtrohet sulmeve ushtarake, me ç’rast kërcënohej me një ofensivë të përgjithshme deri në shkatërrim.

Por, Frowick, që e dinte takatin e forcave policore dhe ushtarake maqedonase si dhe gatishmërinë e UÇK-së që të përparojë edhe në zona të tjera, pasi që e kishte më se të qartë se nga do të silleshin shqiptarët dhe deri ku mund të shkonin me kompromise, siç e kishte të qartë edhe pozicionin e qeveritarëve maqedonas, gjithnjë duke u mbështetur edhe në ato që kishte marrë nga Surroi dhe nga tabori maqedonas, doli me një plan operativ prej tri fazash, që duhej t’u shërbente palëve në konflikt si platformë për ndërprerjen e konflikteve si dhe bisedimet e paqes, që duhej të fillonin menjëherë.

Plani kishte tri faza.

E para parashihte vendosjen e paqes, kohë kjo që parashihej që luftëtarët e UÇK-së t’i dorëzonin të gjitha armët dhe uniformat vëzhguesve të OSBE-së. Luftëtarët, pasi t’i dorëzojnë armët mund t’i kthehen jetës së përditshme dhe punëve që kishin. Qeveria do të shpallë amnisti.

Faza e dytë, parashihet si *kohë mirëbesimi*, për t’u përforcuar dialogu. Në këtë fazë parashihet hapja e universitetit të Shtullit dhe lëshimi i kanali të tretë televiziv për pakicat.

Në fazën e tretë do të negociohej për çështjet me rëndësi të veçantë, si ndryshimi i preambulës së kushtetutës, për përdorimin e gjuhës shqipe e të tjera.

Ndihmësi Foley, bën të ditur se qëndrimi i bashkësisë ndërkombëtare për ndryshimin e preambulës së Kushtetutës është i prerë:

*“Krejt do të shkojë në konceptin qytetar, gjegjësisht definimi i Maqedonisë si shtet i të gjithë qytetarëve, e jo si shtet i popullit maqedonas dhe shqiptar, siç kërkojnë shqiptarët.”*<sup>2147</sup>

---

<sup>2147</sup> „Дневник“, 23 maj 2001.

Foley, po ashtu pranon se tri fazat e pakos së paqes, mund të mbeteshin në letër, po qe se nuk arrihet një marrëveshje për çarmatosjen e UÇK-së, me të cilën ajo do të pajtohej, që nënkuptonte edhe pranimin e kushteve që parashtronte ajo.

Krahasuar me gjuhën përjashtuese që vinte nga zyrtarët maqedonas, Foley ishte më e matur dhe pranë realitetit, ngaqë e dinte se ndërprerja e konfliktit, siç kërkohej nga faktori ndërkombëtar, nuk mund të arrihej me trysni të njëanshme (ndaj luftëtarëve shqiptarë), por me kompromise nga të dyja palët, rreth një marrëveshje të re midis dy popujve për shtetin e përbashkët mbi konceptim e *barazisë qytetare*, pra *shtetit-multietnik*, që ishte opsion edhe i bashkësisë ndërkombëtare. Marrëveshja e re, pa marrë parasysh si do të quhej, kushtëzohej nga marrëveshja paraprake për ndërprerjen e konflikteve, pra të luftës, e cila, po ashtu, nuk mund të ishte as e njëanshme, siç kërkonin maqedonasit, e as pa implementimin e kushteve të luftëtarëve shqiptarë. Si e tillë, kjo marrëveshje, nëse nënkuptonte çarmatosjen e UÇK-së, ajo duhej t'u jepte përgjigje edhe shumë çështjeve të tjera që lidheshin me këtë proces (nga amnistia, rehabilitimi, punësimi, pakoja sociale e të tjera veprime) dhe assesi “falje” ose “lirim nga përgjegjësia” për një vepër penale!

Dhe, do të jetë pikërisht çështja e arritjes së armëpushimit e me të edhe e implementimit të paqes, pika thyese e gjithë çështjes, që do të varej jo nga fjalët e mëdha dhe “kërcënimet” që vinin nga kryetari Trajkovski dhe ushtarakët e tij që nuk ishin në gjendje të arrinin asgjë me ofensivat që ditë për ditë i shpallnin në shtyp, por nga qëndrimi i faktorit ndërkombëtar, konkretisht SHBA-ve dhe NATO-s si duhej lidhur kryet konfliktit, gjithnjë duke pasur parasysh që e gjitha të përfshihet në një pako për marrëveshje dhe assesi ultimatium drejtuar shqiptarëve për kapitullim.

Duke ditë këtë gjë, përfaqësuesit politikë dhe ushtarakë shqiptarë në Prizren ishin përqendruar te një marrëveshje e tyre rreth planit të paqes, që do të justifikonte luftën dhe gjakun që ishte derdhur gjatë atyre muajve nëpër vijat e shumta të fronteve, por në të njëjtën kohë do të pranonte edhe realitetet politike dhe ato të sferave të interesit që lidheshin me ekzistencën e shtetit maqedonas, i cili duhej të nxirrej nga “pronësia maqedonase” dhe “tapitë kombëtare”, që ia kishte dhënë Kushtetuta e vitit 1991, qoftë edhe mbi parimin e shtetit multietnik, për të cilin tashmë mbretëronte ujudi e përgjithshme.

Në përputhje me këto qëndrime dhe pavarësisht gjuhës së ultimatumeve që përdorte qeveria maqedonase, duke i ndërlidhur ato edhe me operacionet ushtarake (“Ogan” në Runicë dhe, “Vaksince”, që sapo kishte filluar dhe përdorej si trysni ndaj faktorit politik dhe ushtarak shqiptar), përfaqësuesi politik i UÇK-së – AliAhmeti, liderët e parive politike – i Partisë Demokratike Shqiptare, Arben

Xhaferi dhe i Prosperitetit Demokratik, Imer Imeri, më 22 maj 2001, nënshkruan deklaratën lidhur me procesin paqësor e reformues në Republikën e Maqedonisë, të njohur si “*Marrëveshja e Prizrenit*”.<sup>2148</sup>

Pajtimi i arritur në mes liderëve shqiptarë mbështetet mbi këto parime:

-njohjen e faktit se reformat, për të cilat angazhohen shqiptarët, kanë qëllim ruajtjen e integritetit dhe karakterit multietnik të Maqedonisë,

-njohjen e faktit se nuk ka zgjidhje “etnike territoriale” për problemet në Republikën e Maqedonisë dhe se çdo përpjekje për të copëtuar etnikisht territoret e u sjell dëm vetë qytetarëve të Maqedonisë,

-njohjen e faktit se nuk ka zgjidhje ushtarake për problemet në RM,

-njohjen e faktit se procesi i transformimeve të RM-së duhet të shkojë drejtë integritimeve euroatlantike,

-njohjen e faktit se zgjidhja do të gjendet brenda një procesi vendor politik me lehtësimin e SHBA-ve dhe BE-së.

Në bazë të këtyre parimeve, liderët shqiptarë të Maqedonisë janë të vendosur që të marrin pjesë në procesin e dialogut reformist, duke trajtuar këto çështje:

-amendamentet në Kushtetutën e Maqedonisë,

-përdorimi i papenguar i gjuhës shqipe, si njëra prej gjuhëve zyrtare të Maqedonisë,

-përfaqësimi përpjesëtimor etnik në institucionet e shtetit,

-zgjerim i kompetencave të pushtetit komunal,

-shekullarizim i plotë i Kushtetutës-shtet,

-vendosja e demokracisë konsenzuale për çështjet, që kanë të bëjnë me të drejtat kombëtare, që do të thotë, kufizim i procesit të mbivotimi në fushat që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me të drejtat etnike,

-e drejta për komunikim të lirë e të papenguar në hapësirën kulturore shqiptare.<sup>2149</sup>

Në marrëveshje përfshihen edhe masat për transformimin e jetës së anëtarëve të UÇK-së në profesione të ndryshme civile, duke përfshirë edhe ato brenda institucioneve qeveritare.

Për nga kërkesat, “*Marrëveshja e Prizrenit*” mbetet në kornizat e Komunikatës numër 6 të UÇK-së nga 9 marsi 2001. Theksohet ruajtja e integritetit shtetëror të Maqedonisë dhe karakteri multietnik i Maqedonisë. Karakteri multietnik i Maqedonisë duhet të arrihet me anën e një dialogu reformues, ku do të ndry-

<sup>2148</sup> “*Fakt*”, më 25 maj 2001.

<sup>2149</sup> Ostreni, Gëzim: “*Ushtria Kombëtare Shqiptare*”, Dibër, 2014, faqe 472.

shohen amendamentet në Kushtetutën e Maqedonisë, me çka, *koncepti i ndryshimeve kushtetuese* si dhe kërkesa për to do të zbutet në *reformë kushtetuese*.

Kërkesat tjera, si ajo për përdorimin e papenguar të gjuhës shqipe, si njëres prej gjuhëve zyrtare në Maqedoni, shekullarizimit të shtetit, përfaqësimit përpjesëtimor etnik në institucionet e shtetit e deri të e drejta për komunikim të papenguar në hapësirën kulturore shqiptare, që u takojnë të drejtave dhe lirive elementare njerëzore universale, janë të vetëkuptueshme në secilën demokraci parlamentare, gjë që tregon, në njërën anë absurdin e ndërtimit të shteteve mbi konceptet shtet-komb, siç ishte ai maqedonas, që doli nga shpërbërja e ish Jugosllavisë në një realitetet shumetnik dhe, në tjetrën anë, të pranimit ndërkombëtar jashtë kriterëve elementare demokratike dhe civilizues, që kthehet në çështje krize deri te lufta.

Këtë më së miri do ta pasqyrojnë reagimet e ashpra, që erdhën rreth Marrëveshjes së Prizrenit nga ana e liderëve shtetëror maqedonas si dhe elitës intelektuale maqedonase, po edhe ato nga faktori ndërkombëtar.

Reagimet nga liderët maqedonas sado që refuzuese dukeshin ishin edhe të pritshme dhe të natyrës së koniunkturave dhe për nevoja të brendshme për vetë faktin se nga trysnia e kryengritjes së shqiptarëve, binte koncepti i shtetit-komb,<sup>2150</sup> mbi të cilin ishte shpallur pavarësia e Maqedonisë në vitin 1991, paçka se edhe koncepti i multietnik, që shfaqej i pashmangshëm, edhe në rrethanat të krijuara nga trysnia e luftës së shqiptarëve, në segmentet kryesore (gjuha zyrtare, simbolet shtetërore, himni e deri te emërtimi zyrtar), shtetit ia ruante karakterin maqedonas.

Të kësaj natyre duhet kuptuar edhe reagimet që erdhën nga faktori ndërkombëtar, që ndonëse shfaqeshin refuzuese ndaj Marrëveshjes së Prizrenit dhe atyre që ajo përmbante, më shumë i referoheshin formës se sa përmbajtjes. Madje, kjo e fundit, me ndonjë përjashtim, në pikat kryesore (ruajtja e integritetit territorial dhe sovranitetit shtetëror, reformat kushtetuese me të cilat shteti maqedonas transformohet nga shteti-komb te shteti qytetar-multietnik) ruante në tërësi qasjen e ndërkombëtarëve ndaj krizës në Maqedoni si dhe zgjidhjes që duhej dhënë, të

---

<sup>2150</sup> Ndër reagimet e intonuar me retorikë që përdorej nga regjimi i Beogradit kundër kërkesave të shqiptarëve për barazi, që ishin shpalosur nga viti 1968, 1991 dhe këndej, për statusin e republikës së Kosovës në federatën jugosllave, ishte edhe ajo e Kiro Gligorovit – ideologut të shtetit kombëtar maqedonas. Marrëveshjen e Prizrenit e dënoi ashpër me fjalët: “Ngjarja që ndodhi në Prizren dhe përcaktimet e hapta, nuk mund t’i komentoj ndryshe pos hyrje për ndërtimin e vendit tonë (Maqedonisë) si shtet binacional, me qëllim të shkëputjes së Republikës së Maqedonisë dhe bashkëngjijtjen e saj Kosovës ose të realizohet ideja e vjetër për krijimin e një shteti shqiptar në Ballkan” (Shih: Глигоров, Киро: „Македонија е се што имаме“, Скопје, 2002, faqe 594).



shpalosura në forumet kryesore ndërkombëtare nga KS i OKB-së, OSBE-ja, BE-ja e deri te NATO-ja, dhe po ashtu, që njëherësh ishin edhe qëndrime zyrtare të SHBA-ve, Britanisë së Madhe, Francës, Gjermanisë dhe vendeve të tjera, të cilat ishin elaboruar edhe në takimet me zyrtarët më të lartë të shteti maqedonas, po edhe me takimet e herë pas hershme me liderët politikë shqiptarë në Maqedoni. Këto qëndrime, po ashtu, vinin edhe nga Shqipëria dhe nga Kosova, ndonëse në rolin e spektatorit të thjeshtë.

Edhe pse SHBA-të, Franca, Gjermania si dhe përfaqësuesit e BE-së sa për sy e faqe, kërkuan nga A. Xhaferi dhe I. Imeri që të heqin dorë nga Marrëveshja e Prizrenit, meqë ajo “kthente në subjekt të marrëveshjes ata që kishin marrë armët”,<sup>2151</sup> megjithatë, ata dëshironin që liderët shqiptarë të mbeteshin në koalicionin qeverisës, i cili, shfaqej si garantues i bisedimeve për paqen dhe marrëveshjeve të ardhme. Ky konstalacion ishte i vetmi që pengonte alternativën e luftës.

Këtë e dinin edhe maqedonasit, që ndonëse sulmonin A. Xhaferin dhe I. Imerin si “bashkëpunëtorë të terroristëve” e të ngjashme, ishin të vetëdijshëm se ata ishin të pashmangshëm dhe madje, edhe të dobishëm për vetë çështjen, ngaqë vetëm me anën e tyre, pengonin shfaqjen e Ali Ahmeti në bisedime të drejtpërdrejta si dhe legjitimitimin e faktorit luftë, që për opinionin maqedonas ishte i papranueshëm, ndonëse edhe luftëtarët ashtu siç flisnin paralajmëronin se do të merreshin me politikë. Maqedonasit, po ashtu e dinin, se me deklarin e UÇK-së për mbrojtjen e integritetit territorial dhe sovraniteti shtetëror të Maqedonisë si dhe tërheqjen e tyre nga kërkesa për *shtetin dy-kombesh*, pra për federalizimin, ia kishin dalë që disfatën në planin ushtarak ta kthejnë në një fitore politike, edhe për vetë faktin se slogani i diskriminimit kombëtar, i dhunës shtetërore ndaj shqiptarëve, “i terrorit demokratik”, e mbi të gjitha i degradimit të shqiptarëve në pakicë dhe të tjera me të cilat kishte filluar kryengritja shqiptare në Tanushë dhe ishte përhapur me të shpejtë në pjesët tjera, ishte rrudhur në atë se “në Maqedoni po luftohet për reforma, luftohet për barazi”,<sup>2152</sup> gjë që gjithë çështjes i jep dimensionin e “gabimeve gjatë procesit të shtetndërtimit”, që mund të korrigjohen me marrëveshje, siç do të ndodhëm me atë të Ohrit.

Dhe, meqë ishte arritur deri te një modus që “reformat demokratike” të shërojnë “gabimet e tranzicioneve demokratike”, siç kishte filluar të fliste propaganda

---

<sup>2151</sup> “Fakti”, Shkup, më 24 maj 2001.

<sup>2152</sup> Shih deklaratën e gjeneralit Gëzim Ostreni, Shef i Përgjithshëm i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së gazetës “Fakti”, 1 qershor 2001.

mediatike e Shkupit,<sup>2153</sup> pra kur UÇK-ja gjithë çështjen e shihte te “receta e reformave dhe shteti multi-etnik”, dhe jo të ndryshimet kushtetuese, atëherë ishte e pritshme, që nga maqedonasit, “intermexoja” midis “luftës dhe paqes” të shfrytëzohet që faktori ushtarak shqiptar, meqë kishte hequr dorë nga kërkesat që do ta rrezikonin shtetin maqedonas dhe nuk paraqiste më kërcënim për copëtimin e tij e të tjera rreziqe që mund t’i vinin, të dobësohet sa më shumë, e me ta edhe faktorët politikë shqiptarë, që do të flisnin me gjuhën e tyre gjatë bisedimeve për paqen.

Kjo në të vërtetë do të shihet me operacionet ushtarake që do të vazhdojnë sapo të jetë shpallur “Marrëveshja e Prizrenit”, me “Vaksince” në katundin Vaksince, më 24 maj 2001 dhe luftimet në Mateç gjatë tri ditëve të ardhshme dhe tëjetërat gjatë ditëve në vazhdimi kur do të sulmohen Sllupçani, Hotëk dhe Orizore.<sup>2154</sup>

Në këto operacione luftime, ndonëse pa pasoja për UÇK-në, e cila edhe më tutje kishte ruajtur pozicionet dhe në disa pjesë edhe kishte përparuar, kishte pësuar popullata. Forcat policore dhe ushtarake maqedonase, me anën e artillerisë qëllimisht kishin bombarduar vendbanimet e shqiptarëve, shtëpitë dhe pronat e tyre madje edhe bagëti. Nuk ishin kursyer as infrastruktura publike. Rreziku që u vinte nga shtrirja e luftës nëpër pjesët urbane, operacionet “spastruese” që kryheshin, kishte detyruar shumë prej banorëve të largoheshin prej zonave të luftës në pjesët tjera të vendit, po edhe në drejtim të Kosovës.<sup>2155</sup>

Kundërpërgjigjja e UÇK-së ndaj këtyre veprimeve luftarake kishte qenë e natyrës mbrojtëse dhe e matur, me lëvizje përpara në drejtimet strategjike pa rrezikuar popullatën dhe pronat e tyre. Të tilla ishin ato në rajonin e Dervenit dhe në Shkup, veçmas në drejtim të Haraçinës, prej nga do të vihen nën mbikëqyrje pikat kryesore përreth Shkupi dhe në drejtim të Kosovës, me çka duhej të ushtrohej trysni e mëtutjeshme edhe ndaj faktorit ndërkombëtar që mbështeste forcat maqedonase.

Veprimet luftarake të forcave policore dhe ushtarake maqedonase të trumbetuara si ofensivë përfundimtare ndaj pozicioneve të UÇK-së për rrënimin e saj, të cilave nuk u besonte kush, në të vërtetë dëmtonin popullatën shqiptare të viseve të shpallura si zona luftime në mënyrë që prej andej të shpërnguleshin me çka ata do

---

<sup>2153</sup> Shih komentin “Demokracia si zhvillim dhe sfidat e bashkëjetesës”, në “Дневник” të Shkupit, më 2 qershor 2001.

<sup>2154</sup> Shih raportet e luftimeve në Sllupan, Mateç, Orizore dhe pjesët përreth në “Fakti”, më 27 maj 2001. Gazeta njofton edhe për përdorimin e helmeve kimike.

<sup>2155</sup> “Дневник”, 29 maj 2001: Vlerësimet e Kryqit të Kuq të Maqedonisë, ku shihet se numri i përonave të zhvendosur nga këto pjesë ishte 13.895 veta: 121.097 nga rajoni i Kumanovës dhe Likovës, 2.420 nga Mali i Zi i Shkupit dhe 1.394 nga Tetova.

t'i paguanin "koston" rebelimit me armë. Por, tymi që vinte nga andej si dhe pamjet e luftës propaganduese, do t'i shërbejnë Trajkovskit për shpalljen e "Planit për paqe", që shprehte idenë "se zhvillimet e mëtutjeshme duhej të drejtohen në dy kahe: Në marrëveshjen për reformat politike, sipas kërkesave të UÇK-së, që duhet bërë me partitë politike shqiptare PPD-në dhe PDSH-në, me kushte që ato të ndiqnin rrugën e veprimit kundër UÇK-së dhe në idenë për zhdukjen e UÇK-së me përdorimin e forcës". Ky plan, në katër faza, duhej të zgjaste jo më shumë se një muaj e gjysmë.<sup>2156</sup>

Në këto rrethana, pra kur Shkupi kishte filluar të keqpërdorte gatishmërinë e shqiptarëve për kompromise të dhimbshme, çfarë kishin bërë në të vërtetë me Marrëveshjen e Prizrenit, më 11 qershor, kemi edhe futjen e njërive të UÇK-së në Haraçinë, vendbanim në hyrje të Shkupit.

Ishin këto operacione spektakulare të luftëtarëve shqiptarë, që për pak iu kthyen strategjisë së luftës, me çka, faktori ndërkombëtar përfundimisht u bind se shteti maqedonas, përkundër fjalëve të mëdha, nuk ishte në gjendje që konfliktit të armatosur me UÇK-në t'i jepte përgjigje ushtarake, pra të fitonte luftën, siç fliste pareshtur. Përkundrazi, u pa qartë, se UÇK-ja ishte në gjendje që ta vazhdonte luftën me sukses dhe në përputhje me të, sipas nevojës, serish t'u kthehej kërkesave maksimaliste: federalizimit të Maqedonisë mbi parimet e shtetit dy-kombesh, ose të kantonizimit.

Haraçina, pra, kur u pa qartë se luftëtarët shqiptarë ishin në gjendje që luftën ta kthenin në mjet të politikës edhe me kërkesat nismëtare që do të mbështeteshin me fakte të kryera (ndarja e brendshme Maqedonisë në përputhje me "Iliridën"), e gjitha i dha përgjigje fundit të luftës dhe fillimit të bisedimeve për paqen, që do të përmyllen me "Marrëveshjen e kornizës së Ohrit", e nënshkruar në Shkup, më 13 gusht 2001.

Ato që ndodhën nga mesi i qershorit deri nga fillimi i gushtit e deri te nënshkrimi përfundimtar, ishin vetëm pjesë e një skenari kryekreje ndërkombëtar (NATO-BE), që i duheshin një epilogu, ku lufta nuk duhej të kthehej në sukses, e as paqja në disfatë, por në një normalitet politik të dobishëm "për të gjithë".

Nga ky këndvështrim duhet parë edhe ato që ndodhen në Maqedoni brenda shtatë muajsh me çka iu hapën dyert tri zhvillimeve:

a) Hyrjes së NATO-s në Maqedoni<sup>2157</sup>

---

<sup>2156</sup> Ostreni, Gërzim: "Ushtria Çlirimtare e Kombëtare", Dibër, 2014, faqe 550.

<sup>2157</sup> Një ditë pas Marrëveshjes së Ohrit, më 14 gusht 2001, me ndërmjetësimin e ambasadorit të NATO-s, Pitter Feit, u nënshkruajt edhe një marrëveshje tjetër midis përfaqësuesit politik të UÇK-së, Ali Ahmetit dhe

b) Ridefinimit të shtetit maqedonas nga shteti kombëtar, në shtet qytetar multietnik, sado që ky formulim shtetit do t'ia ruajë karakterin maqedonas me riformulimin në Kuvendin e Maqedonisë,<sup>2158</sup> dhe

c) Pajtimin të shqiptarëve me realitetet e reja politike në shtetin maqedonas, të cilat mbetën thuajse të njëjta me ato të para luftës.

Si do të shihet, përfituesi më i madh do të jenë liderët ushtarakë të UÇK-së, nga trashëgimia e “Lëvizjes Popullore të Kosovës” (LPK), dega e Zvicrës, që siç kishte ndodhur edhe me rastin e luftës së Kosovës, armët e dorëzuara do t'i zëvendësojnë me ato të posteve të partive politike, do të kyçen në jetën politike të vendit.

“Partia e Demokratike e Integriteteve” (PDI) e Ali Ahmetit, do t'i fitojë zgjedhjet e para “të shteti multietnik” dhe në këtë mënyrë ia doli, që me oreolin “e partisë së luftës”, t'ia marrë primatin politik edhe Arben Xhaferit për të vazhduar ku kishte mbetur ai – kthimit në pjesë të mekanizmave institucional të drejtuar nga politikanët maqedonas pa ia dalë që të ndryshojë gjendjen për të cilën edhe ishte luftuar, gjë që nga ky këndvështrim, kjo luftë, mbetet e papërfunduar.

---

presidentit të ish Republikës Jugosllave të Maqedonis, Boris Trajkovski, për amnistinë e luftëtarëve të UÇK-së dhe çarmatimin e saj. Po në këtë ditë ekspertët ndërkombëtar arritën në Shkup për të filluar punën rreth grumbullimit të armëve nga isht luftëtarët e UÇK-së. Ky operacion u quajt “Korja esenciale” dhe duhej të kryhej nga 3.500-5.000 trupa të NATO-s. (Shih: Rexhepi, Zeqirja: “Zhvillimet politiko-shoqërore të shqiptarëve në Maqedoni, 1990-2001”, faqe 202).

<sup>2158</sup> Më 16 nëntor 2001, Parlamenti i IRJM miratoi vendimin për shpalljen e amendamenteve IV, V, VI, VII, VIII, IX, X-XVIII të Kushtetutës së Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Në Amendamentin IV u ndryshua Preambula e Kushtetutës. Preambula maqedonasve ua merrte të drejtën ekskluzive mbi shtetin e IRJM, me ç'rast, jo vetëm maqedonasit, por edhe shqiptarët dhe bashkësitë jera etnike shndërroheshin në elementë konstitutiv të shtetit. Por, me këtë ndryshim, edhe në rrethanat e shtetit qytetar multietnik, ruhej karakteri i shtetit kombëtar maqedonas, gjë që kjo pasqyrohej me simbolet kombëtare si dhe gjuhën zyrtare (maqedono-nishten), ndërsa shqiptarët dhe të jerët, duke u trajtuar “si pjesë” të popullit, përjashtoheshin nga etnia e tyre e jashtme. Kjo pasqyrohet në këtë formulim, i cili pësoi ndryshim nga ajo që u propozua në Marrëveshjen e Ohrit, me çka marrëveshja u lëndua nga Parlamenti, pra nga parimi i shumicës parlamentare, që solli edhe krizën në Maqedoni për të cilën shqiptarët përdorën luftën:

*“Qytetarët e RM-së, populli maqedonas, si dhe qytetarët që jetojnë në kufijtë e saj të cilët janë pjesë e popullit shqiptar, popullit turk, popullit vllah, popullit serb, popullit rom, popullit boshnjak dhe të tjerëve, duke e marrë përgjegjësinë e së tashmes dhe së ardhmes të atdheut të tyre, të vetëdijshëm dhe mirënjohës ndaj paraardhësve të tyre për flijimet dhe përkushtimet në përkrahje dhe luftën për krijimin e Republikës së Maqedonisë si shtet të pavarur dhe sovran dhe të përgjegjshëm para brezave të ardhshëm për ruajtjen dhe zhvillimin e çdo gjëje që është e vlefshme, nga tradita e pasur kulturore dhe bashkëjetesa në Maqedoni, të barabartë në të drejta dhe obligimet e tyre kah e mira e përbashkët – Republika e Maqedonisë në pajtueshmëri me traditën e Republikës së Krushevs dhe vendimet e ASNOM dhe të referendumit të 8 shtatorit, të vitit 1991, vendosën ta konstitujnë si të pavarur, shtet sovran, me qëllim që të vendos dhe të forcojë pushtetin e së drejtës, të garantojë të drejtat njerëzore dhe lirinë e qytetarëve, të sigurohet paqe dhe bashkëjetesë, të drejta sociale, begati ekonomike dhe përparim të jetës individuale dhe kolektive, përmes përfaqësuesve në Kuvendin e RM-së të zgjedhur në zgjedhjet e lira demokratike”. (Shih: “Службени весник на Република Макеонија”, бр.91, 20 октомври 2001, Скопје).*

## PËRFUNDIM

*Marrja me Mbretërinë e Maqedonisë nga antikiteti si dhe pamja e saj në kohë dhe hapësirë, domosdoshmërisht nxjerr në pah faktorët më të rëndësishëm të një qytetërimi, konceptet e të cilit ishin idetë e universalizimit botëror në planin filozofik, atë shoqëror dhe politik, që u pasqyruan më së miri dhe në mënyrë unike me Perandorinë Botërore të Aleksandërit të Madh. Ndërsa marrja me shtetin maqedonas, të krijuar nga Titoja në shekullin XX në kuadër të konceptit i tij për Jugosllavinë e AVNOJ-it, nxjerr në pah po ashtu faktorët politik që ndikuan shfaqjen e këtij shteti si koniunkturë gjeostrategjike nga kriza lindore e këndeje.*

*Edhe pse Perandoria Botërore e Aleksandërit të Madh, politikisht nuk ishte në gjendje t'u bëjë ballë sfidave të kohës, gjë që si e tillë, në planin shtetëror dështoi, megjithatë mbeti si model i një ideje madhore, e cila, ndonëse nga Platoni, Aristoteli po edhe filozofet tjerë u ngrit në paradigmen e Perandorisë së më të Mirës, megjithatë si model i fuqisë politike dhe shtetërore, në forma të ndryshme, u ndoq nga pasardhësit e tij: Pirro Molosi, Kostandini i Madh, Jusitiniiani e deri te Gjergj Kastrioti – Skënderbeu.*

*Kur zihen ngojë mbretërit dhe perandorët e rëndësishëm, që ndoqën shëmbëllesën politike të Aleksandërit të Madh dhe, fjala është për pasuesit të tij, kihet parasysh aspekti i ndërlidhjes etnike, shoqërore dhe politike me mbretërinë e Maqedonisë si dhe faktin se ajo ishte pjesë e botës pellazge-ilire, e cila, në rrethana të caktuara, siç ishin ato të ndryshimeve të mëdha që ndodhen nga shekujt XIV-X me rastin e dyndjeve të popujve nga Egjipti dhe drejtime të ndryshme në pellgun e saj që shtrihej në hapësirën euro-aziatike, që sollën edhe shkapërderdhjen e fuqisë së saj politike si dhe zhvendosjen në drejtime të ndryshme (Mesdhe dhe Azi të Vogël), Mbretëria Maqedonase mori përsipër rikthimin e fuqisë së shkapërderdhur dhe të humbur, që kishte dikur Troja dardane, perandoria bryge dhe ajo hitite pashmangshëm të lidhur me amëzën paraprake dardane.*

*Marrja dhe nënshtrimi i shteteve-qytete: Athinës, Spartës dhe futja e tyre nën mbretërisë Maqedonase si dhe drejtimi i Aleksandërit të Madh nga Lindja për në*

*Persi dhe tutje deri në Indi, ku mendonte se ndodhej kufiri i Botës, nuk ishin të rastësishme, por pjesë e konceptit të Perandorisë Botërore nga mendësia pellazge, së cilës i duhej një lidhje e brendshme dhe e jashtme politike në përputhje me idetë e qytetërimit të tij.*

*Kështu, modeli i Perandorisë Botërore, si koncept politik, dhe universalizmi si ide filozofike e saj, Mbretërinë e Maqedonisë së Aleksandërit të Madh, e kthejnë në qendër të antikitetit, mbi të cilën lindi ajo që do të quhet helenizëm.*

*Ky fakt, megjithatë, ndryshon pamjen, por edhe përmbajtjen e asaj që si qytetërim, por edhe model politik njëanshëm i është atribuuar helenëve dhe Greqisë, duke përjashtuar kështu faktorët kryesor të saj: botën pellazge-ilire si dhe shtratin e saj etnik, historik dhe politik, prej nga helenizmi përthithi mendësinë, traditën dhe gjithë ato vlera me të cilat u pasurua si qytetërim universal.*

*Në këtë aspekt, mbretëria e Maqedonisë së Aleksandërit të Madh, e përvetësuar nga Greqia politike e shekullit XIX si dhe helenizmi i shpallur njëanshëm “qytetërim grek”, kthehet në “referencë” të saj, në vend se të jetë e kundërta, që helenizmi i dalë nga Pizistrati e këndej, të shihet si trashëgimi e botës pellazge-ilire, e me këtë edhe i asaj Maqedonase si përfaqësuese tipike të fuqisë së saj kur ajo thuhet se ndodhej në grahmenë e fundit pikërisht nga invazionet e jashtme (egjiptiane dhe të tjera), që ndikuan dukshëm raportet shoqërore dhe politike në pellgun e saj.*

*Përvetësimi i njëanshëm i Maqedonisë së Aleksandërit të Madh nga filohelenistët e shekullit të kaluar si dhe vendosja e saj në qendër të Greqisë antike për qëllime politike çfarë ishin ato që lidheshin me rilindjen evropiane mbi modelet e qytetërimit të lirë antik, përkundër dëshmimeve të shumta të autorëve antikë se Maqedonia si dhe Dardania dhe në përgjithësi bota ilire ishin pjesë e botës pellazge, prania e së cilës, ndonëse e shkapërderdhur politikisht, dëshmohej edhe në kohën e shfaqjes së helenizmit, e dëmtoi vetë qytetërimin antik dhe kompleksitetin e tij. Sepse, kjo shkëputje i la të anashkaluar shumë nga faktorët përbërës të antikitetit: nga ata etnikë, kulturorë dhe të tjerë, që u shpallën “indogjenë” ose, kur nuk mund të kapërceheshin dot shkencërisht, njëanshëm u cilësuan me predikatin “paleo” (të vjetër), me çka trashëgimia sikur pranohej, por jashtë ndikimit në të.*

*Ky kundrim, pos që ndihmoi mbajtjen e pikëpamjet e kontestuara të indoevropianishtes dhe skemave të tejkaluara të saj nga shumë aspekte, njëherësh ngriu edhe pikëpamjet po ashtu të kontestuara rreth dyndjes së popujve në hapësirën euro-aziatike si dhe shfaqjen e qytetërimeve që dolën nga këto zhvillime, me*

*ç'rast modeli i arianzmit u desh t'i amputohet doemos lidhja e helenizmit me botën balto-gjermane dhe madje kjo e dyta të shihej edhe si vendimtare në formimin e tij!*

*Këto tetori, që nuk shpëtuan edhe nga qasja raciste, shkencërisht nisën “të amortizohen” vetëm me vlerësimin dhe rivendosjen e faktorit pellazg në themelet e helenizmit si qytetërim antik dhe jo të mohimit të tij të njëanshëm nga “frika” se djepi i qytetërimit antik duhet kërkuar në hapësirën e Mesdheut dhe atë euro-aziatike, ku faktori pellazg-dardan-ilir ndërlidh botën sumere-semite me arianizmin. Ndaj, nuk është e rastit, që do të jenë pikërisht, disa shkencëtarë gjermanë dhe të tjerë (Hahn, Grossman, Müller, Fallermayer, Milan Budimir e të tjerë), të pakënaqur me fetishin e arianizmit të interpretuar në përputhje me filohelenizmin politik, që ngritën tezën e lashtësisë pellazge – djep i qytetërimit antik, ku bota ilire-trakase shihej e ndërlidhur me të dhe assesi e shkëputur nga helenizmi i mbështetur mbi ekskluzivitetin e faktorit grek. Në përputhje me këtë kundrim janë edhe studimet e rilindësve shqiptarë: Kamardës, De Radës, Skriptit, Skiroit, S. Fashërit, Gj. Adhamudhit, P. Vasës dhe të tjerëve, që i dhanë mbështetje lidhjes pellazge-ilire.*

*Në këtë aspekt, Maqedonia antike luan një rol të veçantë dhe tejet domethënës nga pikëpamja etnike, kulturore dhe ajo shoqërore-politike, ngaqë në njërën anë nxjerr në pah faktorin pellazg-ilir, si pjesë e saj e pashkëputshme historike, ndërsa në tjetrën anë, nxjerr në pah edhe vazhdimësinë e tij me botën shqiptare në formën e një modeli identifikues politik dhe shtetëror qysh nga koha e mbretërisë Molose të Pirros, të Mbretërisë së Dardanisë, Mbretërisë Ilire, e deri te Mbretëria e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Andaj, nuk është e rastit që edhe Pirro u identifikua me Aleksandërin e Madh, siç u identifikua shekuj më vonë edhe Skënderbeu, i cili jo rastësisht u quajt Mbret i Epirit dhe Maqedonisë dhe përkrenarja e tij (brirët e dhisë) simbolizonin Aleksandërin e Madh dhe Pirro Molosin.*

*Në njëfarë mënyre, identifikues me idetë e Perandorisë Botërore, por me faktorin krishterim si pjesë e “fuqisë hyjnore”, shfaqen edhe perandorët dardanë-ilirë, Konstantini i Madh dhe Justiniani, të cilët ia vunë themelet Bizantit, duke e kthyer fuqinë e perandorisë në Lindje, në Bizant (në afërsi të Trojës së dikurshme dardane), prej nga ajo, edhe për dhjetë shekuj, shtriu pushtetin e saj politik dhe kulturor nga Lindja në drejtim të Perëndimit.*

*Rënia e Bizantit në shekullin XV si dhe ngritja e Perandorisë Osmane në themelet e kryeqendrës së saj politike dhe shpirtërore – Kostandinopojë, ndonëse*

*qytetërimin perëndimor e ballafaqoi me invazionin islam si një realitet i rij që po ia merrte hapësirën nga qendra shpirtërore dhe historike duke e kthyer në luftë qytetërimesh, megjithatë ishte vepra e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut (lufta tridhjetë vjeçare kundër Perandorisë Osmane), që duke u thirrur në Epirin dhe Maqedoninë, shteti i tij e identifikoi me shtyllat kryesore të qytetërimit antik – si qendër e luftës antiosmane, prej ku qytetërimi perëndimor do të mbrohej, por edhe do të rikthente Lindjen e humbur (Kostandinopojën).*

*Edhe pse me emblemën mbretërore të Skënderbeut dhe luftën e tij emri Maqedoni nga nocioni etnik i lidhur me pellgun historik pellazg-dardan-ilir, në shekullin XX, kthehet në një nocion gjeografik për qëllime politike, megjithatë nga mesjeta e vonshme e deri te koha e re, Maqedonia vazhdon të jetë pjesë e botës arbërore-shqiptare në aspektin shoqëror, kulturor dhe politik. Në mesjetën e hershme, gjatë Bizantit dhe më vonë gjatë Perandorisë Romake, hapësira e Maqedonisë e tëra përfshihet në kuadër të Ilirikut. Organizimi i saj administrativ dhe kishtar, në kohën e Konstantinit të Madh dhe të Justinianit, shihet në kuadër të vikariatit të Dardanisë dhe më vonë nën Themën e Skupit. Në organizimin administrativ të Perandorisë Osmane, hapësira e Maqedonisë Veriore, të shumtën përfshihet në elajetet dhe më vonë vilajetet e Arnaullëkut, pjesa më e madhe e së cilës gjendet në sanxhakun e Shkupit, Manastirit dhe atë të Prishtinës. Me reformën administrative të shekullit XIX, pjesa më e madhe e Maqedonisë Veriore, fillimisht përfshihet në vilajetin e Shkupit dhe pak më vonë në atë të Kosovës dhe të Manastirit. Në vilajetin e Kosovës, me kryeqendër Shkupin, Maqedonia Veriore mbetet deri në vitin 1912, kur gjatë luftërave Ballkanike pushtohet nga ushtria serbe dhe ajo greke.*

*Kahu i Luftërave Ballkanike (pushtimet serbe, greke dhe bullgare) si dhe shembja e Perandorisë Osmane, ndonëse Maqedoninë Veriore (pjesa më e madhe e së cilës shtrihej në vilajetin e Kosovës dhe tjetra në vilajetin e Manastirit), e ktheu në plaçkë lufte të shteteve fqinje (Serbisë dhe Greqisë), megjithatë, ajo luajti një rol tejet të rëndësishëm, madje edhe vendimtar, në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, më 28 nëntor 1912 si realitet i pashmangshëm politik, që ndonëse nuk do të përfillet në kufijtë e saj etnik, do të rikthehet në hartën e re shtetërore evropiane.*

*Ky rol historik i Maqedonisë Veriore në kuadër të vilajetit të Kosovës dhe pjesërisht të atij të Manastirit, bashkë me bërthamën e Dardanisë, ishte i natyrës politike, po edhe kulturore, mbi të cilat u ngrit dhe u zhvillua platformat politike e nacionalizmit shqiptar dhe u drejtua lufta për pavarësi nga Lidhja Shqiptare e*



*Prizrenit e vitit 1878, ku edhe në vitin 1881, me Qeverinë e Përkohshme të Lidhjes Shqiptare në Prizren, u rikthye shteti shqiptar i shembur pas vdekjes së Skënderbeut. Revolucioni Xhonturk i viti 1908, i kurorëzuar me kërkesat e Kuvendit të Ferizajt, që rrënuan absolutizmin hamitian dhe sollën në pushtet turqit e rinj, si dhe kryengritja e Kosovës e vitit 1912, me ç'rast, me Katërbëdhejtëpikshin e njohur të marrëveshjes së Hasan Prishtinës me Perandorinë Osmane, praktikisht u krijua e ashtuquajtura "Shqipëri Osmane", për epiqendër patën një pjesë të Maqedonisë Veriore me atë të Dardanisë.*

*Kështu, në njërën anë, alfabeti i gjuhës shqipe në Manastir, më 1908, dhe në tjetrën anë, Shkupi si qendër ushtarake po edhe politike e kryengritjes shqiptare të vitit 1912, që u çliruar në gusht të atij viti ku edhe u manifestua fuqia politike dhe ushtarake e faktorit shqiptar si e pashmangshme në ato rrethana vendimtare, kthehen në emblemë historike të shqiptarizmit, që i dhanë vulë të pashlyeshme shtetformimit shqiptar.*

*Natyrisht se realitetet politike, që prodhoi Konferenca e Ambasadorëve e Londrës në vitin 1913 (njohja e Shqipërisë së përgjysmuar dhe mbetja e Kosovës e me këtë edhe pjesës më të madhe të Maqedonisë Veriore nën pushtimin serb dhe ajo e vilajetit të Janinës nën atë grek), është dashur që Shqipëria zyrtare, të kthehet në një realitet shtetëror brenda kufijve londinezë, ndërsa pjesët e shkëputura nga etnia shqiptare, me fatin "e pakicave" të shuhen përfundimisht nga lidhja e tyre e brendshme politike dhe kulturore.*

*Ndaj, jo rastësisht, dy nga pjesët emblematike të shqiptarizmit nën pushtimet serbe (Shkupi - kryeqendër e Kosovës dhe Manastiri - qendër e nacionalizmit gjuhësor) kthehen në mohues të tij. Kështu, Beogradi, duke u nisur nga "Naçertanja" dhe platformat që dolën prej saj (Memorandumi i Vasa Çubrilloviqit dhe të ngjashme nga Akademia Serbe e Shkencave dhe e Arteve dhe Kisha Ortodokse Serbe), Shkupin e ktheu në qendër të islamizmit, ndërsa Manastirin në qendër të identitetit ortodoks sllav.*

*Këto dy veprime, u përcollën me programe shtetërore, nga ato të etnocideve: shpërnguljet e dhunshme të shqiptarëve për në Turqi të përcjella me marrëveshjet shtetërore me Turqinë si dhe kolonizimin e trojeve shqiptare me popullatë serbe dhe malaziasë) si dhe të kulturocideve: mohimi i gjuhës shqipe, mohimi i identitetit kombëtar si dhe zëvendësimi i tij me identitet fetar "mysliman" të shoqëruar me kombësinë "turke".*

*Në këtë aspekt, pra që t'i merrej çfarëdo identiteti kombëtar dhe politik, Shkupi – si kryeqytet historik i shqiptarëve, u kthye në qendër "islamike". Për të*

*humbur çfarëdo gjurme shqiptare në të, Beogradi hapi shkollat fetare islamike në Shkup dhe qytetet tjera të vilajetit të dikurshëm të Kosovës. Hapi Madresën e Madhe në Shkup si dhe themeloi Shoqatën e Myslimanëve të Serbisë “Xhemjeti”, që mori përsipër edhe organizimin e tyre politik me “qevre jeshile”.*

*Krahas kësaj, asimilimit të plotë iu nënshtruan edhe shqiptarët ortodoksë, të cilët, në pjesët e Maqedonisë Veriore dhe të Kosovës, u shpallën “serbë”. Të njëjtit, në kohën e Titos, u shpallën maqedonas.*

*Edhe përkundër këtyre represalieve shtetërore dhe programeve për zhdukjen e identitetit etnik dhe kulturor shqiptar, shqiptarët nuk hoqën dorë nga të qenit shqiptarë. Kjo u pasqyrua me rezistencën e vazhdueshme deri te ajo e armatosur, si dhe shfrytëzimin e rrethanave historike, siç ishin ato midis viteve 1915-1918 dhe 1941-1944, që t’i bashkohen etnisë shqiptare. Ngjashëm do të veprohet edhe nga viti 1944 e këndej, kundër ripushtimeve sllavo-kokmuniste si dhe realieteve që sollën ato me krijimin e Jugosllavisë së Titos, deri në vitin 1991, kur ajo u shpërbë dhe shqiptarët serish do të gjenden në kuadër të koniunkturave të reja: në Maqedoni në kuadër të shtetit të pavarur të Maqedonisë, ndërsa në Kosovë nën ripushtimin e Beogradit.*

*Shpallja e shtetit të pavarur maqedon në vitin 1991 mbi parimet shtet-komb, pra si shtet nacional i Maqedonasve si dhe përfshirja e shqiptarëve në të si pakicë jashtë vullnetit të tyre, ngaqë bojkotuan referendumin e shtator të vitit 1991, këtij realiteti nuk ia trazoi legjitimitetin.*

*Edhe pse pak më vonë, shqiptarët nëpërmes një referendumi, në vitin 1992, do të shpallin republikën autonome të “Iliridës”, megjithatë kjo nuk e ndryshoi realitetin politik, ngaqë ky përcaktim nuk u ndoq deri në fund dhe me të gjitha mjetet sa nga arsyet që lidheshin me Kosovën dhe rrezikun që mund të sillte atje destabilizimi i Maqedonisë të cilën e dëshironte edhe Beogradi për hesape të veta, dhe sa nga konformizmi i një pjese të faktorit politik shqiptar, i akomoduar në strukturat shtetërore prej nga përfitonin personalisht nga postet në qeveri e deri te ato të ambasadorëve (por pa ndonjë ndikim politik).Kjo bëri që shteti maqedonas edhe si i tillë, pra njënacional, vazhdoi të mbështetej ndërkombëtarisht dhe madje të merret edhe “si oazë paqeje”.*

*Kjo “idilë” gjithsesi se i shkonte për shtati politikës nacionaliste maqedonase, meqë ashtu arrinte dy qëllime: shkëputjen e shqiptarëve nga Kosova dhe lidhja e njohur kulturore dhe shpirtërore me të e krijuar midis viteve 1968-1981, si dhe “pajtimin” e tyre me shtetin kombëtar maqedonas me tretmanin e pakicës, që ata njëherësh do t’i mbante të shkëputur nga Kosova po edhe Shqipëria.*

*Kjo gjendje, megjithatë, filloi të trazohej sapo Kosova të futet nën protektoratin ndërkombëtar në qershor 1999. Nxjerrja e saj nga pushtimi serb si dhe vendosja e trupave të NATO-s në të, ndryshuan edhe “idilen” maqedonase. Shqiptarët, të diskriminuar nga “demokracia parlamentare”, në fillim të vitit 2001, filluan një kryengritje, e cila me të shpejt, nga Tanusha, përfshiu pjesët e banuara me shqiptarë. Bartëse e kësaj lufte ishte “Ushtria Kombëtare Çlirimtare”, një simotër e “Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”, jo vetëm përnga pjesëmarrja e shumë luftëtarëve në luftën e Kosovës, por edhe përnga koncepti që “lufta të kthehet në mjet të fundit të politikës”.*

*Por, lufta e UÇK-së, nga shkurti deri në gusht të vitit 2001, e filluar me moton e çlirimit kombëtar, vazhdoi me kërkesën për shtetin dy-kombësh (shqiptarë-maqedonas, gjegjësisht maqedonas-shqiptar), papritmas u rruadh në kërkesën për shtetin e përbashkët demokratik-qtetar, multi-etnik.*

*Me këtë kërkesë gjërat arritën deri te Marrëveshja e Ohrit e gushtit 2001, me të cilën, ndërkombëtarisht, iu vunë bazat shtetit qytetar të Maqedonisë, ku megjithatë, Maqedonia, me gjuhën zyrtare maqedonase si dhe simbolet shtetërore maqedonase, ruajti karakterin nacional maqedonas, por nën firmën shtetit qytetar.*

*Sidoqoftë, lufta e shqiptarëve në Maqedoni, ndonëse përfundoi pa ndonjë sukses politik, megjithatë, ndërkombëtarizoi çështjen e saj deri në atë masë sa që qenia e shtetit maqedonas të shihet e lidhur ngushtë me raportet e shqiptarëve me të, që mund t’ia përcaktojnë kurdoherë fatin, nëse nuk do të trajtohen si pronar të njëmend të tij, pra si shtetformues, me tapitë historike dhe etnike.*

*Andaj, si e tillë, kjo luftë mbetet e papërfunduar.*

.....

## LITERATURA DHE BURIMET

### BURIME DOKUMENTESH

- ACTA ALBANIAE I,II (M. Šufflay-K.Jeriček-L.Thalloszy), 1913.
- Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare* (1878-1912), Tiranë 1978.
- Austro-Hungarian Document relating to Macedonia struggle* 1869-1912, Thesaloniki, 1967.
- Auerswald, Philip E/Auerswald, David: *“The Kosovo Conflict. A Diplomatic History Throug Documentes*, Cambridge/Den Haag 2000.
- BOGITSCHEWITSCH Dr. M: *“Di auswärtige Politik Serbiens 1903-1914”*, I-III, Berlin, 1928-1931.
- British documents on the originsof he War* 1898-1914, I-IV, London, 1927-1936.
- Documents diplomatiques. Affaires Balkaniques* 1912-1914, I-III, Paris, 1923.
- “Diplomatische Aktenstücke betrefenddie Eereingnise auf dem Balkan”*, herausgegebenvon Österreichisch-Ungarischen Ministeriumdes Äußen 1914“ (*Aktet diplomatike rreth ngjarjeve ballkanike“*, botuara nga Ministria e Jashtme e Austro-Hungarisë“ -1914).
- Die grosse Politik derEuropäischenKabinette* 1871-1914, Berlin.
- Dokumenti o spolnjjojpolitici Kraljevine Srbije 1903-1914, knjiga V, sves-ka 14/27 1912. Srpska Akademia Nauka i Umetnosti, Beograd., Shkup, 2008.
- Dokumente bullgare për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare 1912. Përgatitur nga dr. RamizAbdyliHHStA – Haus-Hof-und Staatsarchiv, PolitischesArchiv, Wien. Albanien, III –XXXVIII (1871-1918);Türkei, IV (1879 -1882).
- “La Macedonie. Recueil de documents et materiaux”*, Sofja, 1980.
- MinisterdesAfferesEntrageres – Documentsdiplomatique: Negatiations relative a la rectificationdesfrontiers de la Grece*, I-II, Paris, 1880,1881.
- NOVOTNY,ALEKANDER: *“ Quellen und StudeinezurGeschihedesBerlinerKonresses 1878”*,Graz – Koln, 1957.
- „Österreichisch – UngarischesRotbuch. AktenstückeausCorrespondenzendes K. u K. gemeinsamenMinisteriumsdesÄusserenüberorientalischeAngelegenheiten“*, I-IV, Wien, 1878-1880.

„*Österreichisch – Ungarns Aussenpolitik von der Bosnischen Krise 1908 bis zum Kriegsausbruch 1914*“, I-VIII, Wien und Leipzig, 1930.

PRIBRAM A. F.: „*Die politischen Geheimverträge Österreich - Ungarns 1878-1916*“, Wien, 1920.

FARLATI, Daniel: „*Illyrici Sacritomus septimus*“, Venetiis, 1817.

FARLATI, Daniel: „*Illyricum Sacrum*“, Jacopo Caleti, Tomas Septimus, Venetiis, 1819.

THALLOCY, Ludevicus – JERICEK, Konstantinus – SUFFLAY, Emilianus: „*Acta et Diplomatares Albaniae mediae aetatis illustrantia*“, I-II, Vindebonae, 1913, 1918.

ТОМОЦКИ, Томо „*Документи од Виенската архива за Македонија од 1878-1903*“, Скопје, 1955.

„ТУРСКИ ИЗВОРИ НА БУЛГАРСКАТА ИСТОРИЈА“ X, s. XV-XVI, Софије, 1964.

VERDENE, G: „*Quistion (La) des reforms fans la Turquied’Europe. Exposedocumentaire*“, Paris, 1903.

Српски извори за историјата на македонски народ (1912-1913), избор Гане Тодоровски, Скопје 1971.

## LITERATURA HISTORIOGRAFIKE

ADAMIDI, D: „*Les Pelasges et leurs Descendants les Albanias*“, 1903.

ABBOT and JOHNSON: „*Municipial administration in The Roman Empiri*“, London 1926.

ABDYLI, Ramiz: „*Trojet Lindore Shqiptare në Kryengritjen e Përgjithshme 1912*“, Shkup, 2012.

Abdyli, Ramiz: „*Lëvizja kombëtare shqiptare 1908-1919*“, 1,2 - Prishtinë, 2004.

ATTALEIATES, Michal: „*Historia*“, Bonnae, 1837.

ALFÖLDY, Geza: „*Bevölkerung und Gesellschaft der römischen Provinz Dalmatien*“, Budapest, 1965.

ALFÖLDY, Geza: „*Die Personennamen in der römischen Provinz Dalmatien*“, Heilderberg, 1969.

ALPAN P. Nexhip – KAÇI, Nasi: „*Shqiptarët në Perandorisë Osmane*“, Tiranë, 1992.

ANTWERPFINE, J: „*Macedon, Illyria and Rome*“, 1936.

- AJETI, Idrizdr: *“Studime dialektore dhe mitologjike”*, Tiranë 2005.
- “ANONYMI DESCRIPTIO EUROPÆ OREINTALIS”, boti O. Gorka, Cracoviae, 1916.
- ANAMALI, Skënder: *“Ilirët dhe qytetet e Ilirisë së jugut në mbishkrimet e Gregisë”*, në *“Iliria”*1982, I.
- ANAMALI, Skënder: *“Epoka e Justinianit në Shqipëri”*, në *“Iliria”*, 1997, 1-2.
- AREF, Mathieu: *“Shqipëria – odiseja e pabesueshme e një populli parahe-len”*, Tiranë, 2007.
- AREF, Mathieu: *“Mikenët=Pellazgët”*, Tiranë, 2008.
- ARAVANTINOUS, Panajotis: *“HronografiatesEpiru”*, Athenai, 1850.
- Арсовски, Митко: *“ОслободителнавојнавоМакедонија”*, Скопје, 1973.
- Arifi, Feri: *“Tanusha në rrjedhën e historisë”*, 2015.
- Ahrens, Geert-Heinrich: *“ContainingEtcnivConflict”*, Uashington, 2005.
- Albrecht,Ulrich/Schefer, Paul: *“DerKosovo-Krieg. Fakten,Hintergrunde,Alternative”*,Köln, 1999.
- BARIC´, Henrik: *“Hyrje në historinë e gjuhës shqipe”*, Prishtinë, 1986.
- Baldacci, Antonio: *“L’Albania”*, Roma, 1929.
- Bajrami, Hakifdr: *“Rrethanat politike-shoqërore në Kosovë më 1918-1941”*,Prishtinë,1981.
- Bajrami, Hakif: *„Naçertanja – program politik serb për shfarosjen e shqiptarëve 1844-1999”*,Prishtinë, 2004.
- Bartl, Peter: *“Myslmanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësi kombëtare 1878-1912”*, Tiranë, 2006.
- Басилјевић, ХаџиЈован: *„Прешевскиобласт: ЈужнаСтараСрбија“*, Београд 1903.
- Banac, Ivo: *“NacionalnoPitanje u Jugoslaviji”*, Zagreb, 1988.
- BARIŠIĆ, Franjo: *“Dosadašnjipokušajubikacije grada Justiniana Prima”*, Zagreb, 1963.
- Bilandić, Dušan: *„HistorijaSocialističkeFederativne Republike Jugosla-vie“*, Zagreb. 1974.
- Bozić, Ivan: *“IstoriaJugoslavije”*, Beograd, 1972.
- Boue, Ami: *“La Turqueid’Eurpe”*, Paris, 1840.
- Brancoff, D.M : *“La macedoine et la populationchretienne”*, Paris, 1905.
- Both, K: *“The KosovoTragedy: The Human Rights Dimension”*, Londër, 2001.
- Brend, J. Fischer: *“Shqipëria gjatë Luftës 1943-1945”*, Tiranë, 1999.

Bruckley, M dhe Cummings, S: *“Kosovo Perspective of Warandits Aftermath”*, Londër,2001.

Brestovci, Sadullah: *“Marrëdhëniet shqiptare-serbo-malazeze 1830-1878”*, Prishtinë, 1983.

Boekh, Katrin: *“Von den Balkankriegen zum ErstenWeltkrieg. Kleinstaa-tenpolitik und ethnische Selbstimmung auf dem Balkan”*, München, 1996.

Brunner, Georg: *“DerTransformationsprozess in Mittel-und Osteuropa. WachsendeProblene mit den Ethnien”*, München,1999.

Butka, Uran: *“Mukja – shans i bashkimit, peng i tradhtisë”*, Tiranë 1998.

Buxhovi, Jusuf: *“Kongresi i Berlinit 1878”*, Prishtinë, 2008.

Buxhovi, Jusuf: *“Nga Shqipëria Osmane te Shqipëria Europiane”*, Prishtinë, 2010.

Buxhovi, Jusuf: *“Kosova”*, I,II,III,IV, V, Prishtinë, 2015.

Bogdani, Pjetër: *“Letra dhe dokumente”*, Shkodër, 1997.

BLANCUS, Franciscus: *“Dictionarium Latino-Epiroticum”*, Romae 1635.

BENAC, Aloiz: *“Predlliri, Protollir i Pralliri – neki novi aspekti”*, ne *“Balcanika”* VIII-1977.

BENLOEW, Lusi: *“Greqia para Grekëve”*, Tiranë 2008.

BENAC, Aloiz: *“O identifikaciji Ilirskogetnosa”*, ne Godišnjak CBI XI-1973.

BENAC, Aloiz: *“O učesćullira u Englesjkojseobi”*, AR JAZU IV-V, 1967.

BECK,H.G: *“Kirsche und theologischeLiteratur in ByantinischenReich”*, München, 1925.

BENGSTON, H: *“GreichiescheGeschihtevondenAnfangen bis in derrö-mischeKeizerzeit”*, München 1965.

BETTINGEN,W: *“KönigAntigonaDosonvonMakedonien”*, Jena 1912.

BERNAL, Martin: *“Athina e zezë”*, Tiranë, 2009.

BUDIMIR, Milan: *“Iliri i pralliri”*, Beograd, 1952.

BUDIMIR, Milan: *“Grci i Pelasti”*, Beograd, 1950.

BUDIMIR, Milan: *“O etničkom odnosu Dardanaca prema Ilirima”*, JIČ III-1973.

BUDIMIR, Milan: *„Pelasto - Slavica“*, Beograd, 1951.

BUDIMIR, Milan: *„Iliriski problem i leksička grupa Teuta“*, Beograd,1953.

BUDIMIR, Milan: *“Mesto arbanskog u krugu indoevropskih jezika”*, në *“Gjurmime albanologjike”*,2/1965.

BUDIMIR, Milan: *“O Ilijadi i njenom pesniku”*, Beograd, 1940.

BUZUKU, Gjon: *„Meshari“*,1,2, Prishtinë, 1987.

- BÜCHNE: “*Dardania*”, Real Encyklopädie der klassischen Altertumswissenschaft IV, 1901.
- BOURCARTS, J. L: “*L’ Albanie et les Albanais*”, Paris, 1821.
- BENAC, Aloiz: “*Mbi proceset etnogjenetike dhe përcaktimin e kufijve tokësor të fiseve Ilire*”, në “*Studime Historike*”, 1972, 4.
- BUDA, Aleks: “*Ilirët e jugut si problem i historiografisë*”, në “*Kuvendi i Studimeve Ilire*”, (15-20 shtator 1972), I, Tiranë, 1974.
- BUDA, Aleks – ZAMPUTI, Injac - FRASHËRI, Kristo - PETRO, Petraq: “*Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë*”, II shek. VIII-XV”, Tiranë, 1962.
- BLUNDELL, S :”*The Origins of Civilization in Greece*”, 1986.
- ÇABEJ, Eqrem: “*Studime gjuhësore*” I-VIII, Prishtinë, 1976.
- CARLMANN, Flor: “*Zur Geschichte der Pelazger*”, Klagenfurt 1860.
- CANTACUZENUS, Joannes: “*Historiae*”, I-III, Bonn, 1828-1832.
- CHONIATES, Nicetas: “*Historia*”, Bonn, 1835.
- CHERKEZI, A.B: “*Albania – Pastand prezent*”, New York, 1919.
- CEROVIĆ, I: “*Nalazi iz praistorijskih tumula u Donjoj Bitinji kod Uroševaca*”, Beograd, 1991.
- COMNENA, Anna: “*Alexias*”, I-III Bonn, 1928.
- COBANES, P: “*Epirus in the Roman period*”, 1997.
- CHONIATES, Nicetas: “*Historiae*”, Bonn, 1835.
- ČOVIĆ, Borivoje: *Osnovne karakteristike materialne kulture Ilira na njihovom centralnom području*“, në „Simpozijum o teritorialnom i hronološkom razgraničenju Ilira u preistorijsko doba“( 15-16 maj 1964), Sarajevë, 1964.
- ČERŠKOV, Emil: „*Antička bistazene iz Klokota*“, Glasnik Muzeja Kosova i Metohije III-1958.
- ČERŠKOV, Emil: „*Municipium D.D. kod Socanice*“, Prishtina-Beograd 1969.
- ČERŠKOV, Emil: „*Rimljani na Kosovu i Metohiju*“, Beograd 1969.
- COWGILL, Warren: “*Indogermanische Grammatik*”, Band I, Heidelberg, 1929.
- ČOVIĆ, Borivoje: „*Osnovne karakteristike materialne kulture Ilira na njihovom centralnom području*“, Sarajevo 1964.
- CVETKOVIĆ-TOMASEVIĆ, G. :”*Ulpijana –arheološka iskopavanja u središtu i južnom delu antičkog grada*”, Beograd 1983.
- CINGIROY, Asen: “*Goti i Geti*” I,II, Sofja 2008.
- CIMOCHOWSKI, W: “*Diesprachliche Stellung des balkanillyrischen im Kriese der indogermanischen Sprachen*”, StudAlb, 10-1, 1973.
- Castelan, Georges: “*Histori des Balkans XIV-XX siecle*”, Paris, 1991.



Cana, Zekeria: "Lëvizja kombëtare Shqiptare në Kosovë 1908-1912", Prishtinë, 1979.

Cana, Zekeria: "Socialdemokracia serbe dhe çështja shqiptare 1903-1914", Prishtinë, 1986.

Carrinton, Lord: "A Soldier's Peace", 1994.

Klark, Howard: "Civil Resisitanc in Kosovo", Londër 2000.

Klark, Wesley: "Të bësh luftë moderne" Prishtinë, 2007.

Clewing, Konrad/Reuter, Ernst: "Der Kosovo-Konflikt. Ursachen, Akteure, Verlauf", München, 2000.

Cenčić, Vjećeslav: "Titova posljednja ispojest", Zagreb, 1984.

Colovic, I: "The Politics of Symbol in Serbia", Londër, 2002.

Covic, N: "Serbia after Milosevic: Program for the Solution of the Crisis in the Pcinja Distric", Beograd, 2001.

Colokotronis, V: "La Macedonie et l'Hellenisme", Paris, 1919.

Češkov, E: "Rimljani na Kosovu i Metohiji", Beograd, 1969.

Ćorović, Vladimir: "Odnosi između Srbije i Austro-Ugarske u 20 veku", Beograd, 1992.

Čubrilović, Vasa: "Iseljavanje Arnauta". VojnoIstorijski Institut JNA. Nr. 3, fasë 4. Kutia 69.

Čubrilović, V i Čorović, V: "Srbija od 1858 do 1903", Beograd.

Čosić, Dobrica: "Stvarno i moguće", Lubjana-Zagreb, 1988.

Čosić, Dobrica: "Srpsko pitanje – demokratsko pitanje", Beograd 1992.

Čosić, Dobrica: "Kosovo 1965-1999", Beograd, 2004.

Črikanović, Fedro: "Jugoslavija između dva rata", Zagreb, 1968.

Цвијић, Јован "Основе за географију и геологију Македоније и Старе Србије", 1,2,3, Београд, 1987.

Цвијић, Јован: "Балканско Полуострво и Јужнословенске земље", Београд, 1987.

Цвијић, Јован: "О етнографији македонских словена", Београд 1906.

Churcher, B: "Kosova Lindore/Presheva 1999-2002 and dhe FYROM Conflict, RMA Sandhurst CSRC G-104, 2002.

Chlumetzky, Leopold Frh: "Östereich-Ungarn und Italien", Wien, 1904.

Qosja, Rexhep: "Çështja shqiptare – historia, politika", Prishtinë.

DANO, Luljeta: "Perëndesha Athina dhe simbole të tjera kozmogomike", Tiranë 2007.

D'ANGELY, Robert: "Enigma nga Pellazgët te Shqiptarët", Tiranë 1998.

Donald E. Pitcher: *An Historical Geography of the Ottoman Empire from Earliest Times to the End of the Sixteenth Century*, Leiden, 1972.

DETSCHEW, Dimitar: „*Die thrakischen Sprachreste*“, Wien 1957.

DOMASZEWSKI, A. V: „*Die Entwicklung der Provinz Moesia*“, *NeuHeidelberg Jahrbücher*, Jg.I-1891.

DOZON, Auguste: „*Exursionen Albanie*“, Paris 1875.

DEMIRAJ, Shaban: „*Epiri, Pellazgët, Etruskët dhe Shqiptarët*“, Tiranë 2013.

DE SIMONE, Carlo: „*La lingua messapica oggi: un bilancio critico*“, 1990.

DURANT, Will: „*Istorija civilizacije*“, Beograd 1995.

DURANTE, Marcello: „*Il nome di Pesaro e l'accento iniziale in Illirico*“, Roma 1951.

DURIDANOV, I: „*Illyrische flussnamen in Serbien*“, 1963.

DUŠANČIĆ, S: „*Novi Antinojev natpis i Metalla Municipii Dardanorum*“, *Živa Antika*, nr.16/1971, Shkup.

DRINI, Faik: „*Ilirët dhe Epirotët (Paralele dhe veçanti)*“, në „*Iliria*“, 1982,2.

DROYSEN, J.G.H : „*Das Dardanische Fürstentum*“, në „*Kleine Schriften zur alten Geschichte*“, Bd.I, Leipzig, 1893.

DROYSEN, J.G.H: „*Paonien und Dardanien-ethnographisches-geschichtliches*“, Leipzig, 1893.

DIL, Sharl: „*Istorija vizantijskog carstva*“, 1919.

DOBRUNA – Salihu E: „*Plastika dekorative dhe figurative e stelave mbivarrore të periudhës romake në Kosovë*“, në „*Gjurmime albanologjike*“, 14/1985, Prishtinë.

DUŠANIĆ, Slavko: „*Novi Antinojeve natpis i metalla municipii Dardanorum*“, në *Živa Antika* XX/1, Shkup, 1971.

DJURIC, Nataša: „*Ilirski tumuli kod Suve Reke*“, Prishtinë 1964.

DZINO, Danijel: „*Illyricum in Roman Politics*“.

Dimitrevic, B : „*Jugoslavia i NATO*“, Beograd, 2003.

Duham, Edith: „*Njëzet vjet ngatërresa ballkanike*“, Tiranë, 1994.

Durham, Edith: „*Shqipëria e epërme*“, Tiranë, 2012.

Duizings, Gerlachus: „*Religion and the politics of identity in Kosovo*“, Londer 2000.

Dukovski, Darko: „*Makedonien und Jugoslawien Konflikt*“, 1999.

Dedijer, Vladimir: „*Novi prilozi za noviju biografiku Josipa Borza Tita*“, vëllimi i tretë, Beograd, 1984.

Dedijer, Vladimir: „*Jugoslovensko – albanski odnosi*“, Beograd 1949

- Dermaku, Ismet: “*Gjon Serreçi dhe NDSH-ja*”, Prishtinë, 2002.
- Dosja Sekrete e UDB-së “*Emigracioni shqiptar 1944-1953*”, Prishtinë, Tiranë, 2004.
- Djordjević, Vladan:” “*Albanien und das Großmähte*”, Laipzig, 1913.
- EPIRUS: “*Epirus. 4000 yearsofGreek histori andcivilization*”, Athens, 1997.
- EFENDI, Wassa: “*Albanien und dieAlbanensen*”, Berlin 1879.
- EGGER, Rudolf: „*BalkanpodRimljanima*“, në „Knjiga o Balkanu“ II, Beograd, 1973.
- EVANS, JohanArtur: „*Antiquarianresearches in Illyricum*“, Parts. I-IV, Westminster – London, 1883-1885.
- FALASKI, V.Nermin: “*Pellazgët, Ilirët, Etruskët, Shqiptarët*”, Prishtinë 2004.
- FALLERMAYER: „*GeschichtedesKaisertumsTrapenzunt*“, München, 1827.
- FALLMERAYER: „*DasAlbanesische Element in Grichenland*“, në „*AbhandlungenderHistorischenKlassederKoenigliche Akademi derWissenschaft*“, vol. VIII, Secsion III, München, 1860.
- FASHËRI, Mehdi: „*Historia e lashtë e Shqipërisë dhe e Shqiptarëve*“, Tiranë, 2000.
- FRASHËRI, Kristo: “*Etnogjeneza e Shqiptarëve*”, Tiranë 2013.
- FRASHËRI, Kristo: “*Historia e qytetërimit shqiptar*”, Tiranë 2008.
- Frashëri, Kristo: “*Historia e Kosovës*”, vëllimi I, Tiranë, 2008.
- Frashëri, Kristo: “*Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881*”, Tiranë, 2012.
- Frashëri, Kristo: “*Viset shqiptare në KamusAl-Alam*”, vepra 3, Shkup, 2004.
- FALKENHAUSEN, Vera von: „*Untersuchungen der die byzantinischen Herrschaft in Südditalien vom IX bis XI Jahrhundert*“, Wiesbaden, 1967.
- FERMENDJIN, Eusebius: „*Monumenta spectantia historiam Slavorum meridionalum, Acta Bosnae*“, Zagrabiae, 1892.
- FERRI, Naser: „*Monumentet ushtarake të periudhës romake në Mëzi të Epërme*“, Pejë, 2001.
- FLUS M: „*Illyrioi*“, Suplement V, Stutgard, 1931.
- FEYEL, M:”*Paul-Emile et le synedrion macedonien*”.
- FRANKE P.R: „*Alt Epirus und das Königtum der Molosser*“, Kallmunz, 1955.
- „Fjalor i mitologjisë“ (hartuar nga Todi Dhamo), Prishtinë, 1988.
- FINE, J. V. A: „*Macedon, Illyriaand Rom*“, në „*Jorunalof Roman Studies*“, XXVI/1936.
- FOURNET, Arnaud: “*The Pelasgian pre-greek Substrate*”.
- Frundlich, Leo: “*Albaniens Golgotha*”, Wien 1913.

- Ethnographische und statistische Mitteilungen ber Albaninen*, Gotha, 1938.
- Gadin, MarieAmeliavon: “*Aus de neçen Albanien*”, Win, 1914.
- GABLER, H: “*Makedonien als römische Provinz*”, 1902.
- GATTI, Ettore: „*Gli Iliri*“, 1-2, Chiaravalle, 1981.
- GALOVIĆ, R: „*Predionica, neolitsko naselje kod Prištine*“, Prishtinë, 1959.
- GALOVIĆ, R: “*Halstatski depo iz Janjeva*”, Prishtinë 1960.
- GAVELA, Branko: “*O Ilirskom substratu na Balkanu*”, Godišnjak, CBI III/1, 1965.
- GARAŠANIN, M: “*Rugovo „Fushe“, Djakovica – praistorijska nekropola sa humkama*“, Beograd, 1966.
- GARAŠANIN, M: “*Istorijska i arheološka razmatranja o ilirskoj državi*“, Beograd, Glas CCLX-1974.
- GARAŠANIN, M: „*O poreklu i hronologiji balkanskog neolita*“, në Stari-nar, r.s. VII-VIII/1956.
- GARAŠANIN, Draga: “*Iliri*“ në „*Iliri i Daçani*“, Narodni Muzej Beograda, 1971.
- GASPĚR, Gjini: „*Skopsko-prizrenska biskupija kroz stoljeća*“, Zagreb, 1986.
- GAVELA, Branko: „*O Ilirskom substratu na Balkanu*“, në Godišnjak CBI III/1, 1965.
- GAVRILOVIĆ, M: “*Miloš Obrenović*“, Beograd 1912.
- GEORGIEV, Vladimir I: „*Die Träger der kretische-mykenischen Kultur, ihre Herkunft und ihrer Sprache.*“ I. Teil: Urigriechische und Urillyrier (Thrako-Ilyrier), 1937.
- GEORGIEV, Vladimir I: „*Die Herkunft der Namen der grössten Flüsse der Balkanhalbinsel und ihre Bedeutung zur Ethnogenese der Balkanvölker*“, në BE. I/1959, Sofija.
- GEORGIEV, Vladimir: “*Тракиски мезитик*“, Софија, 1957.
- GELICH, Giuseppe: „*Monumenta spectantia historiam Slavorum Meridionalium Monumenta Ragusana*“, I-V, Zagrabiae, 1879-1897.
- GESCH, A: “*Die Deutsche Politik in Macedonischen Frage bis zur Turkischen Revolution 1908*“, Danzing, 1932.
- GELICH, Guiseppo: „*Zeta dhe dinastia e Balshajve*“, Tiranë, 2009.
- GERLACH: „*Geschichte des lateinischen Kaiserreiches*“, Hamburg, 1905.
- GRAHAM J Walter: „*The palces of Crete*“, 1962.
- “*Grosse Politik der Europäischen Kabinetten 1871-1914*“, Band. 12, Berlin, 1923.

- GREEN, WilliamHenry: *“Albania and its People”*, 1857.
- GRIMPERA, P.B: *“Elproblemo indoeurpeo”*, Mexiko 1960.
- GLIŠIĆ, J: *„Iskopavanje na lokalitetu Gladnice kod Gračanice“*, Beograd, 1959.
- GLIŠIĆ, J – JOVANOVIĆ, B: *„Fafos II – Kosovska Mitrovica, naseljevin-čanske grupe“*, Beograd,1961.
- GLIŠIĆ, J – JOVANOVIĆ, B: *„Praistorisko naselje na Gladnicama kod Gračanice“*, GMKMII/1957.
- GIBBON, E: *„Historyof the Declineand Fall of the Roman Empire“*, Lon-  
don,1896.
- GIESE, Friedrich: *“Die Altosmanischen Ancymen Chroniken”*.
- ГОРИЕВ, Драги – ШЕРИФИ, Ахмет: *„Салнамена вилаетот Косово“*, Скопје, 2012.
- ГОЦЕВ, Д: *„Национало-ослободителната борба б Македонја 1912-1915“*,Софиј,1981.
- GOTLIB, Christian von Gissner: *“Die alten Pelazger und ihre Mysterien”*,Leipzig 1825.
- Glenny, Misha: *“DerKrieg, dernach Europa kam”*, München 1993.
- Glenny, Misha: *“Historia e Ballkanit 1804-1999”*,Tiranë
- Giesbsch: *“Reisedurch Rumelien und Brussa”*, Wien, 1864.
- Grow, James: *“Triumphof the Lackof Will:Internationale Diplomacy and the Yugoslav War”*,Londër 1997.
- Гопчевић, Спиридон: *“Стара Србија и Македонија”*, Београд, 1890.
- Guliamo, San A: *“Briefe ber Albanien”*, Lajpzig,1913.
- Guzina, Ružica: *“Opštine u Srbiji 1913-1918“*, Beograd, 1976.
- Gjeçovi, Shtjefën: *“Vepra”*, 1,2,3,4, Prishtinë.
- Gjeçovi, Shtjefën, Konstantin: *“Kanon Leke Dukadjinija”*, Zagreb, 1986.
- Gjeçovi, Xhelal: *“Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës”*, Tiranë, 1998.
- HADŽIBEGOVIĆ H., HADŽIĆ A & KOVAČEVIĆ E: *“Oblast Brankovi-ća,opširini katarski popis iz 1455 godine”*, I-II,Sarajevo, 1972.
- Haxhiu, Ajet: *“Hasan Prishtina dhe lëvizja politike e Kosovës”*, Tiranë, 1964.
- Handley, J : *“Russiaand the Balkans”*, Londër, 2008.
- Hass, Gerhard/Schuman, Wolfgang: *“Anatomi der Agression – Neue Doku-mente zu den Kriegszielen der faschistischen deutschen Imperialismus in Zweiten Weltkrieg”*, Berlin, 1972.
- HASLUCK, F. W: *“Chrisianity and Islam nder the Sultans, I-III, Oxford, 1929.*

Hrabak, Bogumil: *“Albania od Julske krize do proljeća 1916, na osnovu ruske diplomatike građe”*, „Obeležja“, Prishtinë, 1973.

Hrabak, Bogumil – Janković, Dragoslav: *„Srbija 1918“*, Beograd, 1968.

Hrabak, Bogumil: *„Reokupacija oblasti srpske i crnogorske države s arbanaskom većinom stanovništva u jesen 1918. Godine i držanje Arbanasa prema uspostavljenoj vlasti“*, „Gjurmime Albanologjike“, Prishtinë, 1969, nt. 1.

HASSELMEYER, Ellis: *“Die Pelasgerfrage und ihre Lösbarkeit”*, Tübingen, 2005.

HAHN, Johan Georg von: *„Studime shqiptare“*, Tiranë, 2009.

HAMMOND, Nicol G.L: *„Varrimi në tumat në Shqipëri dhe problemet e etno-gjenezës“*, në „Studime historike“, 1972,4.

HAMMOND, Nicole G. L: *“Epirus”*, Oxford, 1967.

HAMMOND, Nicole G.L: *“A History of Macedonia”*, Oxford, 1972.

HAMP, Eric P: *„Albanian and Messapic“*, në „Studies presented to Joshua Whatmoghonhis sixtieth birthday”, S.Gavenhage, 1957.

HAAS, Otto: *“Mesapische Studien”*, Heilderberg 1926.

Hoti, Izber: *“Forcat e armatosura në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore”*, Prishtinë, 1998.

Hofbauer, Hannes: *“Balkankrieg. Der Zerstörung Jugoslawiens”*, Wjenë 1999.

Hockenos, Paul: *“Homeland calling – etile patriotism and Balkan wars”*, Londër 2003.

“Historia e Popullit Shqiptar”, I-IV, Tiranë 2002-2098.

Heinemann, A dhe W. Paes: *“Wag the Dog: The Mobilisation and Demobilisation of the Kosova Liberation Army”*, Bon dhe Shkup, 2000.

Hibbert, Regi-nald: *“Fitorja e hidhur”*, Tiranë, 1993.

HUNGER, Herbert: *„Das Regiesterdes Patriarchats von Konstantinopel“*, I, Wien, 1981.

HOMMOND, N.G.L: *“Epirus”*, Oxford 1967.

HOPF, Ch: *„Geschichte Grichenlands vom Beginnendes Muiltelaters bis auf unserZeit“*, 1876.

„Historia e Popullit Shqiptar“, I, II (grup autorësh), Prishtinë, 1969.

„Illyrisch albansiche Forschungen“, vol. I-II, München dhe Leipzig, 1916.

„Ilirët dhe Iliria tek autorët antikë“, Prishtinë, 1979.

„Ilirët dhe gjeneza e Shqiptarëve“, Tiranë, 1969.

„Ilirët“ (S. Islami, S. Anamali, M. Korkuti dhe F. Prendi), Tiranë, 1985.

HOLLEAUX, M: *„The Romans in Illyria“* në CAH vol. VII/1953.

HERTZERBERGER: „*Geschichte der Byzantiner und des Osmanischen Reiches bis gegen Endedes XVI Jahrhunderts*“, Berlin, 1883.

HECQUOARD, Hyacinthe: “*Histori et description de la Haute Albanie au Guerguerie*”, Paris, 1858.

HEYD, W :“*Geschichte des Levantehandels in Mittelalter*“, Stuttgart, 1879.

IPPEN, Theodor: “*Deux episode des L’Histori de l’Albanie*”, 1927.

Islami, Hivzi: “*Popullsia e Kosovës – studim demografik*”, Prishtinë, 1981.

IzzetPascha, Ahmet: “*Denkwüdigkeit endes Marschalls Izzet Pascha*”, Leipzig, 1927.

Ivanoski, Sandra: “*Konflikt u Makedoniji 2001*”, Shkup, 2008.

ИВАНОВСКИ, О: „*Македонски тесловениод VI до IX век*“, Скопје, 1962.

“*Istorija Naroda Jugoslavije*”, Beograd, 1963.

„*Иторијана Македонскиот народ*“, I, II, Скопје, 1969.

Историјана Македонскиот народ“, Институт за национална историја, Скопје, 2000.

Институт за национална Историја: „*Књигаза Илинден*“, 1969.

“*IIIYRICUM SACRUM*” I-IX, Prishtinë, 2004.

JORGO, Nikolae: “*Breve historie de l’Albanie et desAlbanais*”, Bucarest, 1919.

Joetze, Gunter: “*Derletzte Krieg in Europa? Das Kosovo und die deutsche Politik*”, München, 2001.

Judah, Tim: “*Kosova, luftë dhe hakmarrje*”, Prishtinë 2002.

Jevtić, Atanasije: “*Stradanja Srba na Kosovu i Metohiju od 1941 do 1990*“, Prishtinë, 1990.

JACQUES, Edwin: „*Shqiptarët – historia e popullit të lashtë nga lashtësia deri në ditët tona*“, Tiranë.

JAMES, Bonwick: “*The Treasury of Langues Rudimentary Dictionary*”, London 1873.

JOKL, Norbert: „*Illyrier, Reallexion derVorgeschichte*“, 6, Berlin, 1926.

JOKL, Norbet: „*Untersuchungen zur indogermanischen Schpach-und Kulturwiissenschaft-Linguistisch-kulturhistorischeUntgersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen*“, Berlin und Leipzig 1923.

JOKL, Norbert: „*Thraker*“ në ERL VI/1926.

JUBANI, Bep: „*Tiparët e përbashkëta në ritin e varrimit tek Ilirët e trevës së Shqipërisë*“, në „*Ilirët dhe gjeneza e Shqiptarëve*“, Tiranë, 1969.

JIRIČEK, Konstantin: „*Historia e serbëve*“, I, II, Tiranë, 2010.

JERIČEK, Konstadin: “*Albanien ind der Vergangenheit*”, në “*Illyrisch-Albanische Forschungen*”, band I, München und Leipzig 1916.

JERIČEK, Konstantin: “*Skutari und sein Gebit im Mitteilatter*”, në *Illyr. Alba. Forshungen I band*, 1916.

JERIČEK, Konstantin: “*Istorja na Balgarite*”, Sofja, 1928.

JOSIFOVSKA, Borka: “*Dva latinska nadgrobna natpisa iz Kavagilje-Scupi*”, në *ZA XVI/1956*.

КАЦАРОВ, Г: „*Леонија, Приноск'мстаратаетнографија и историјана Македонија*“, Софја, 1921.

КАТАРАНО, ХН: “*Thoti fliste shqip*”, Tiranë 2007.

KANIZ, F: “*Das Königreich Serbien und das Serbien Volk*”, Band II, Leipzig, 1908.

KATIČIĆ, Radoslav: „*Die illyrische Personennamen in irem südostlichen Verbretingsgebiet*“, në „*Živa Antika*“, Shkup, 12, 1962, flet.1.

KATIČIĆ, Radoslav: “*Antroponime ilire dhe problemi i etnogjenezës së Shqiptarëve*”, në “*Studime filologjike*”, 1972,4.

KATIČIĆ, Radoslva: „*Liburner, Pannonier und Illyrier*“, në „*Studien zur Sprachwiessenschaft und Kulturkunde*”, Insbruck, 1968.

KATIČIĆ, Radoslav: “*O jeziku i narodnosti starih Makedonaca*”, *Godisnjak CBI XIII/11*, 1976.

KATIČIĆ, Radoslav: “*Ancienc lingua gesof the Balkans*”, Paris 1967.

KATIČIĆ, Radoslan: „*Peonci i njihov jezik*“, 1977.

KUNIC A Domic: “*Literarni izvori za Iliricke provincije*”.

KUBISCHEK, I “*Ein römische Strassenkarte*”, *JÖAI VI/1902*.

KOPITAR, B.J.: “*Albanische, walachische und bulgarische Sprache*”, Wien 1829.

KOLA, Aristidh P: “*Arvanitasit dhe prejardhja e Grekëve*”, Tiranë, 2002.

KOKA, Aristotel: “*Kultura Ilire parahistorike në Shqipëri*”, Tiranë, 1985.

KOVALJEVIĆ, G: “*Kasno atička palata u Nerodimji*”, Prishtinë, 1958.

KOVALJEVIĆ, G: “*Antičkinovci u Janjevuza Zbirku Zemaljskog muzeja u Sarajevu*”, Prishtinë, 1984.

KORKUTI, Muzafer: “*Paleoliti në Shqipëri*”, në “*Iliria*”, 1995, 1-2.

KORKUTI, Muzafer: “*Parallirët, Ilirët, Arbrit*”, Tiranë, 2007.

KONDA, Spiro N: “*Shqiptarët dhe problemi Pellazg*”, Tiranë, 1964.

KRISPI, Xhuzepe: “*Shqipja nënë e gjuhëve*”, Palermo 1831.



- KIEL, Machiel: *“Ottoman Architecture in Albanien (1385-1912)”*, Istanbul, 1990.
- KUHNE, Florian: *“Die Rolle der Illyrer in der Antiken Geschichte”*.
- KRAHE, Hans: *“Die alten Balkanillyrischen geographischen Namen”*, Heidelberg, 1925.
- KRAHE, Hans: *“Die Sprache der Illyrer”*, I,II Die Quellen, Wiesbaden, 1955.
- KRAHE, Hans: *“Beiträge zur illyrischen wort-und Nahmen-forschung”*. Indogermanische Forschungen LVIII. Band, Zweites Heft. 1941.
- KRAHE; Hans: *“VonIllyrischen zum Alteuropäischen“*, nē IF 69/1964-65, Berlin.
- KRAHE; Hans: *“Sprache und Vorzeit. Europäische Vorgeschichte nach dem Zeugnis der Sprache”*, Heilderberg, 1954.
- KRAHE, Hans: *“Das Venetische. Seine Stellung im Kresi der verwandten Sprache”*, 1950.
- KRETSCHMER, E: *“Einleitung in dieGeschichte der griechischen Sprache”*, Göttingen,1896.
- KRETSCHMER; E: *„Die Leleger und die ostmediterraneÜbervölkerung“*, nē Glotta XXXII/1953.
- KRETSCHMER, P: *“Dituria gjuhore indogjermane”*, Tiranë, 1925.
- KRONASER, H: *“Zum Stand der Illyristik”*,LB.4, 1962.
- Kelmendi, Ibrahim, profesor: *“E vërteta mbi gjendjen e shqiptarëve në Jugosllavi”*, Preshevë, 1994.
- Kelmendi, Ibrahim, profesor: *“Një shtyllë e Kosovës quhet Preshevë”*. Preshevë, 2006.
- Kola, Harilla: *“Gjenocidi serb ndaj Shqiptarëve në viset e tyre etnike në Jugosllavi, 1941-1967”*,Tiranë, 2000.
- Kohl, Christinevon: *“Albanien”*,München 1998.
- Kokolari, Hamid: *“Kosova – djepi i shqiptarizmit”*, Tiranë, 1943.
- Krizman, Bogadan: *“Elaborat dr Ive Andrica o Albaniji iz 1939 godine”*. *“Casopiszasuvremenupovijets “1977, nr 2, f. 77-99.*
- Krsitć, Đorđe: *“Kolonizacija južne Srbije”*, Shkup, 1928.
- Krizman, Bogdan: *“Elaborat dra Ive Andrića o Albaniji iz 1939 godine.”* *Časopis za suvremenu povijest”, 2/1977, 77-90.*
- Kuntzel, Matthias: *“Der Weg in den Krieg: Deutschland, die NATO und das Kosovo”*, Berlin 2000.

- LAKE, W. M: "Travels in Nothern Greece", III, London, 1841.
- LAKE, W. M: "Paiones", 1942
- Lalaj, Ana: "Kosova – rruga e gjatë drejt vetëvendosjes 1948-1981", Tiranë, 2000.
- Lamaj, Idriz: "Marrëdhëniet partiake-shtetërore Shqipëri-Jugosllavi", New York, 1977.
- Lamaj, Idriz: "Komiteti Kombëtar Shqipëria e Lirë", New York 2000.
- Libald, Michael: "Balkan", München, 1987.
- Libald, Wolfgang: "Das Ende Jugoslawiens. Selbstzestörung, Krieg und Onhmacht derWelt", Vjenë 1993.
- Lita, Qerim: "Naçertanja – K. Cërvenkovski dhe identiteti shqiptar në Maqedoni 1945-1954", Shkup, 2007.
- Lita, Qerim: "KQ i NDSH-së dhe Azem Marana". Tiranë, 2011.
- Lita, Qerim: "Shaban Efendia – atdhetar i devotshëm". Kumanovë, 2010.
- Lita Qerim, "Tokat e liruarra 1941-1944", përmbledhje dokumentesh në katër vëllime. Shkup 2014.
- Lita, Qerim: "Territoret lindore shqiptare 1912-1960". Shkup, 2016.
- Lita, Qerim: "Çështja shqiptare në RSFJ 1981-1990". Shkup, 2014.
- Lita, Qerim: "Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974", dokumente në gjashtë vëllime. Shkup, 2018.
- Lory, Bernard: "Europa ballkanike nga 1945 deri në ditët tona", Tiranë, 2007.
- LAÇEJ, Naim: "Tanagra", Lezhë 2012.
- LEAKE, W.M: "Researches in Greece", London 1814.
- LEAKE, W.M: "Travels in Northern Greece", London 1835.
- LECLERQUE, H: "Illyricum", në – Dictionared'archeologiechretienne et deliturgjie", VII/1, Paris 1926.
- LEVEQUES, Paul: "Pyrrhos", Paris, 1957.
- Nasi, Lefter: "Ripushtimi i Kosovës shtator 1944- korrik 1945", Tiranë, 1994.
- Nasi, Lefter: "Aspekte të shtypjes kombëtare e politike të shqiptarëve në Kosovë 1981-1986", Tiranë, 2011.
- Novaković, Kosta: "Nacionalizacija i srbizacija", Wien, 1913.
- Novaković, Kosta: "Çetiri meseca u Srednjoj Albaniji", Borba, knj.7, 1914, Beograd.
- NEUMANN: "Der vierte Kreuzzug", Berlin, 1898.
- NORDEN, Eduard: "Alt Germanen Völker und namengeschichtliche", Leipzig 1934.

NDROQI, Majlinda: *“Shënime për çështjen Pellazge dhe kulturën popullore”*, Tiranë 2007.

NORWICH, John Julius: *“Bizanti – shkëlqimi dhe rënia e një perandorie 330-1453”*, Tiranë, 2005.

NOVAK; Grga: *„La nazionalita dei Dardani“*, në Arhiv za Arbanasku Starinu, Jezik i Etnologjiju, knjiga IV/1, Prishtinë, 1969.

NOWAK, Peter: *“Sie besigten Atlantis – Die Geschichte der Pelasgeraus antiken Quellendargestelt”*.

NIEBUR, G.B.: *“The Roman History”*, London 1827.

NIKOL, Donald M: *„The Despotate of Epiros“*, I-II, Oxford, 1957, 1984.

NIESE, B: *“Geschichte der griechischen un makedonischen Staatenseit Schlacht bei Chdronea”, II. Vom Jahre 281 v. Ch. Bis zur Begründung der römischen hegemoni in griechischen Osten 188 v. Ch.”*, Gotha, 1899.

MALTE-BRUN, Conrad: *“Melangesscientifiques et Litteriares”*, Paris 1828.

MAY, J.M.F: *“The Coinage of Damastion”*, Oxford 1939.

MAYER, Antun: *“Die Spracheder alte Illyrier”*, I, II, Wien, 1957-1959.

MARQUET Odet: *“Pjetër Bogdani. Letra dhe dokumente”*, Shkodër, 1997.

Matković, Hrvoje: *“Povijesti Jugoslavije 1918-1991-2003”*, Zagreb, 2003.

MATKOVSKI, Aleksandar: *“Kryengritja e Dërvish Carës”*, Tetovë, 2012.

MAJANI, Zahari: *“Fundi i misterit etrusk”*, Tiranë 1973.

MARIN, E: *“Pristupno istraživanje jllirskie onomastike na Apeninskom poluotoku”*, ZA.27,2/1977.

MAYER, Anton: *“Die Spracheder alten Illyrier”*, I-II, Wien, 1957-1959.

Marko, Joseph: *“Der Mindeheiten schütz ind den jugoslawischen Nachfolgenstaaten”*, Bon 1996.

MELONI, Piero: *“Perseo e la fine della monarchia Macedone”*, Roma, 1953.

MERKER, L: *“The Ancient of Paionia”*, 1965.

MIKULČIĆ, Ivan: *“Pelagonija u svetlosti arheoloških spomenika Egejskese sobe od Augusta”*, Skopje, 1966.

Meier, Viktor: *“Wie Jugoslawien verspielt wurde”*, München, 1995.

Meier, Viktor: *“Jugoslawiens Erben: Die neuen Staaten und die Politik des Westens”*, Munih 2001.

Milo, Paskal: *“Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927”*, Tiranë, 1991.

Mihačević, Lovro: *“Po Albaniji”*, Zagreb, 1950.

Мирославевски, С – Томоски С: *„Албанците во Република Македонија 1945-1995“*, Скопје, 1997.

Melčić, Dunja: *“Der Jugoslawien-Konflikt. Handbuch zu Vorgeschichten, Verlauf und Konsequenzen”*, Wiesbaden 1999.

M.Schmid-Neke: *“Entschtehung und Ausbauder Königsdikatur in Albanine 1912-1939”*, München, 1987.

MOCSY, Andras: *“Gesellschaft und Romanisation in der römischen Provinz Moesia Superior”*, Budapest 1970.

MOMMSEN, Theodor: *„Verzeichnis der römischen Provinzen“*, Berlin, 1951.

MEYER, Gustav: *“Kurz gefasste Albanische Grammatik”*, Leipzig 1888.

MEYER, G -LÜBKE, Wilhelm: *“Rumänisch, romanisch, albanisch”*, Heilderberg 1914.

MARCHIANO, Stanislai: *“La Lingua Pelasgo-Albanese”*, në Studio Filologicis volti, Napoli 1882.

MALCOM, Noel: *“Kosova”*, Prishtinë, 2001.

MAKUŠEV, Vikentij Vasilijev: *“Istoričeskije razyskonija o slovjanah v Albanii v srednje veka”*, Varšava, 1871.

MÜLLER, C.O: *“The History and Antiquities of the Doric Race”*, London 1830.

MÜLLER, C. O: *„History Of The Literature Of Ancient Greece”*, London 1839.

MILAJ, Jakov: *“Raca shqiptare”*, Tiranë 1944.

MIKLOSICH, Franz - MÜLLER, Johannes: *„Acta et Diplomata Graeca mediae visacra et profana“*, 1, Wien 1860.

MIKLOSICH, Franz: *“Die slavischen Elemente in Albanische”*, Wien 1870.

MIKULČIĆ, Ivan: *„Teritori Skupa“*, në ŽA. XX-2, 1971.

MIOČEVIĆ – RENDIĆ, Duje: *„Iliri u natpisima grčkih kolonija u Dalmaciji“*, në VAHDLIII/1951.

MIOČEVOĆ – RENDIĆ, Duje: *“Ilirski vladari u svijetlu epigrafskih numismatičkihi zvara”*, në HZ, XIX (1966-1967), Zagreb, 1968.

MITKO, Thimi: *“Bljeta shqiptare”*, Aleksandria, 1878.

MIRDITA, Zef: *“Studime dardane”*, Prishtinë, 1979.

MIRDITA, Zef: *“Antroponomia e Dardanisë në kohën romake”*, Prishtinë, 1981.

MIRDIA, Zef: *“Eine Inschrift aus Ulpiana”*, në *“Zeitschrift für Papyrologi und Epigraphik”*, bnd.29, 1978, Bonn.

MOSCY, A: *“Gesellschaft und Romanisation der römischen Provinz Moesia Superior”*, Budapest, 1970.

MOSSO, A: *“The Palaces of Cretë and Theri Buildes”*, Londër, 1957.

MOMMSEN, Th: *“Römische Geschichte”*.

MUTAPFCIEVA S – DIMITROV S: “*Sur l’etatdu sisteme de timar des XVII-XVIII siecles*”, Sofia, 1968.

UTERMANN, Jürgen: “*Die messapischen Personennamen*”, 1964.

Oschlie, Wolf: “*Gros-Staatenauf dem Balkan, Ursprung, Formen und Folgendes ethnischen Imperlialismus*”, in *Südosteuropa*”, Berlin 2002.

Obradović, Milovan: “*Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu 1918-1941*”, Instituti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1981.

Owen, David: “*Balkan-Odyse*”, Londër 1995.

Osmani, Jusuf: “*Kolonizimi serb i Kosovës*”, Stamboll, Prishtinë, 2010.

Ostreni, Gëzim: “*Shpresa dhe zhgënjimi i shqiptarëve në Maqedoni gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore*”, Prishtinë, 2000.

Ostreni, Gëzim: “*Ushtria Çlirimtare Kombëtare – shkaqet lufta dhe pasojat në Maqedoni në vitin 2001*”, Dibër, 2014.

ORBIN, Mauro: “*Ilregno degli Slavi*”, Pesaro, 1601.

OŠTIR, Karl: “*Beiträge zur alarodischen Sprachwissenschaft*“, I Wien-Leipzig, 1921.

PATSCH, Carl: „*Dardani*“, në Real Encyklopädie, IV/1901.

PATSCH, Karl: “*Ilirët*”, Tiranë, 1923.

PATSCH, Karl: “*Realen eycyclopädia der Classischen Altertumswissenschaft*“, Stuttgart.

PATSCH, Carl: „*Japodi*“, në GZM BiH, X/2-3. 1898.

PALMER; R.L: „*Mycenaeans and Minoans. Aegeanpre history in the lightof the Linear B.tables*“.London 1965.

PALLATTINO, M: “*La civilisationetrusque*”, Paris 1949.

PANDELI, J.W. “*Historia e nënës Shqipëri*”, Tiranë 2010.

PARLAGNELI, Oronzo: “*Studimessapica*”, Milano 1960.

PAPAZOGLU, Fanula: “*Dardanska onomastika*”, në “Beogradski Univerzitet”, Zbornik Filozofskog Fakulteta, libri 8, Beograd, 1964.

PAPAZOGLU, Fanula: “*Politička orgsnizacija Ilira u vreme njihove samostalnosti*”, Sarajevë, 1976.

PAPAZOGLU, Fanula: “*Poreklo i razvoj Ilirike države*”, në Godišnjak CBI V-3, 1967.

PAPAZOGLU, Fanula: “*Srednjobalkanska plemena u predrimska doba*” (*Tribali, Autoriati, Dardanci, Skordisci i Mezi*), Sarajevë 1969.

PAPADOPULOS, A: “*Versuch einer Genealogie der Paliologen 1295-1435*”, Amsterdam, 1962.

PAROVIĆ-PEŠIKAN,M: „*Nekažapazanja o urbanom razvoju Ulpiane – ispitavanje ulica*“, Ohër,1989.

PARINO, Guisepe: „*Acta Albaniae Vaticana, res Albaniae saeculorum XIVatque cruceatan spectantia*“, I, Citta del Vaticano, 1971.

PEDERSEN, Holger: „*Die Gutturale in Albanischen*“, në Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung, 36/1900.

PEDERSEN, Holger: „*Die albanische L-Laute*“, 1897.

PEŠIĆ, Radivoje: „*Vinčanska kultura*“, Beograd 1992.

PEYFUSS Max Demeter: „*Shtypshkronja e Voskopojës 1731-1769*“, Tiranë, 2002.

PETZOLD, Karl-Ernst: „*Rom und Illyrien. Ein Beitrag zum römischen Aussenpolitik im 3. Jahrhundert*“, në „*Historia*“, Wiesbaden, 20/1971, H. 2-3.

PËRZHITA, Luan: „*Mbretëria dardane*“, Tiranë, 2009

PETER, Schreiner: „*Die byzantinischen Klein chroniken*“, I, Wien, 1975.

PEZA, L&PEZA,Liljana: „*Dritë e re mbi Pellazgët dhe gjuhën e tyre*“,Geer, 2009.

PETROVIĆ, Vladimir: „*Dardania u rimskim itinerarima*“, Beograd 2007.

PISANI, Vittore: „*Ilirët në Itali*“, në „*Studime filologjike*“, 1972,4.

PITTONI, Richard: „*Die urgeschichtlichen Grundlagen der europäschen Kultur*“,Wien, 1949.

PILIKA, Dhinitri: „*Pellazgët – origjina e jonë e mohuar*“, Tiranë, 2005.

PISANI, Vitore: „*La linguadei Messapi*“, 1971, në „*Archivo Storico Pugliese*“, Anno XXIV,1971.

PRASCHNIKER, Camillo: „*Muzakhia und Malakastra, Archeologische Untersuchungen in Mittelalbanien*“, në „*Jahresheften des Österreichischen archeologischen Institues*“, Wien, 2122/1921-1924.

Prishtina, Hasan: „*Nji shkurtim kujtimesh mbi kryengritjen shqiptare 1912*“, Bari 1925.

PerritJr, Henry H: „*Ushtria Çlirimtare e Kosovës – Rrëfimi prej brenda për një kryengritje*“,Prishtinë 2008.

Petranović, Branko:„*Istorija Jugoslavije 1918-1978*“, Beograd, 1980.

Petric,Wolfgang/Pihler Robert: „*Rruga e gjatë në luftë. Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare*“,Prishtinë 2002.

Perritt, Jr. Henry: „*Ushtria Çlirimtare e Kosovës*“,Prishtinë, 2008.

Petrović, Branko: „*Revolucija i kontrarevolucija u Jugoslaviji 1941-1945*“, Beograd, 1983.

- Petranović, Branjo: *“Istorija Jugoslavije 1918-1978”*, Beograd, 1980.
- Pirraqu, Muhamet: *“Mulla Idrizi Gjilani dhe Mbrojtja e Kosovës Lindore 1941-1945”*, Prishtinë, 1995.
- Paulsen, Thomas: *“Die Jugoslawien politik der USA 1989-1994”*, Baden-Baden 1995.
- Placzek, Norbert: *“Der Kosovo-Konflikt. Genese und Perspektive”*, Hamburg 1996.
- Pipa, Arshi: *“Stalinizmi shqiptar”*, Tiranë, 2007.
- Popović, Janićije: *“Kosovo u ropstvo pod bugarima 1915-1918”*, Leskovac, 1921.
- Popović, Janićije: *„Topličkiustanak“*, Beograd, 1956.
- Phillips L, David: *“Çlirimi i Kosovës – diplomacia këmbëngulëse dhe ndërhyrja e SHBA-ve”*, Tetovë, 2015.
- PRENDI, Frano: *“Neoliti dhe eneoliti në Shqipëri”*, në *“Iliria”*, 1976, VI.
- PRENDI, Frano: *“Epoka e bronzit dhe e hekurit në kërkimet shqiptare”*, në *“Iliria”*, 1998, 1-2.
- PRENDI, Frano - BUDINA, Dhimosten: *“Kultura Ilire e luginës së Drinosit”* në *“Studime historike”*, 1971, II.
- PRIFTI, Leonard: *“Shqiptarët, Grekët dhe serbët”*, Tiranë, 2010.
- PRIFTI, Leonard: *“Theogonia dhe mitologjia pellazge”*.
- PTOLEMAEUS, Claudio: *“Geografia”* ed. O. Cuntz, Berlin, 1923.
- POLIBIJE (POLYBIUS): *“Istorije”*, Beograd 1960.
- POUQUEVILLE, F-C,H.-L: *“Travels in Epitus, Albania, Macedonia and Thessaly”*, London 1921.
- POPOVIĆ, Relja: *“Neka pitanja iz Justinianove kodifikacije”*, Beograd, 1928.
- POPA, Theofan: *“Të dhëna mbi princët mesjetarë shqiptarë në mbishkrimet e kishave tona”*, në *“Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës”*, seria e shkencave shoqërore, 1957/2.
- Rakić, Milan: *“Konsulska pisma 1905-1911”*, Prosveta, Beograd, 1985.
- Rajović, Radoshin: *“Autonomia e Kosovës”*, Prishtinë, 1987.
- Reinhard, Klaus: *“KFOR – Streitkräfte für den Frieden”*, 2010.
- Reissmüller, Johann Georg: *“Jugoslawien. Vielvölkerstat zwischen Ost und West”*, Köln 1971
- Reiter, Erich: *“Der Krieg um das Kosovo 1998/99”*, Mainz 2000.
- Ristovski, B: *“Makedonija i Makedonska nahija”*, Shkup, 1995.
- Reuters, Jens: *“Die Albaner in Jugoslawien”*, München, 1982.

Rushiti, Liman: *“Lëvizja kaçake në Kosovë 1918-1928”*, Rilindja, Prishtinë, 1981.

Rushiti, Limon: *“Rrethanat politiko-shoqërore në Kosovë 1912-1918”*, Prishtinë, 1986.

Rieger, Henriette: *“Einmal Daytonn und zurück. Perspektiven einer Nachkriegsordnung im ehemaligen Jugoslawien”*, Wien, 1999.

Reiter, Erich (Hrsg): *“Der Krieg um das Kosovo”* 1998/99, München, 2000.

Rüb, Matthias: *“Balkan Transit. Das Erbe Jugoslawiens”*, Vjenë 1998.

Rüb, Matthias. *“Kosovo. Ursachen und Folgen eines Krieges in Europa”*, MuniH 1999.

RADOJEVIĆ, Nikola: *“Srpska istorija Mavra Orbija”*, Beograd, 1950.

RADONIĆ, J: *„Dubrovačka akta i povelje“*, SANU, Beograd, 1839.

RADUNIĆ, J: *“Rimska Kurija i južnoslovenske zemlje od XVI do XIX veka”*, Beograd 1950.

REINHOLD, C.H.T : *“Noctes Pelasgicae”*, Athenis, 1854.

REMERAND, Gabriel: *“Ali de Tebelen Pascha de Janina 1747-1822”*, Paris, 1928.

RENDIĆ-MIOČEVIĆ, Duje: *“Iliri i antički vijet”*, Split, 1989.

REDENIĆ-MIOČEVIĆ, Duje: *“Municipium riditarum në Dalmaci, trashëgimi i tij epigrafik dhe onomastik Ilir”*, në „Kuvendi I i Studimeve Ilire“, II, Tiranë, 1974.

RIX, Helmut: *“Eine morphosyntaktische Übereinstimmung zwischen Etruskisch und Lemnisch. Die Datierungsformel”*, në *“Studien zur Sprachwissenschaft und Kulturkunde”*, Innsbruck 1968.

RUSSU, I: *“Studi Ilirice”*, Bukurest, 1960.

ROBERT Cyprien: *“Les slaves de la Turquie”*, Paris, 1852.

USHAKU, Ruzhdi: *“Ndihmesa onomatologjike nga hapësira Iliro-arbërore”*, Prishtinë 2006.

Universiteti i Tiranës (grup autorësh): *“Historia e popullit shqiptar I, II”*, Prishtinë, 1969.

Uka, Sabit: *“Dëbimi i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit dhe vendosja e tyre në Kosovë”*, Prishtinë, 1994.

Uka, Sabit: *“Gjurmë mbi shqiptarët e Sanxhakut të Nishit deri më 1912”*, Prishtinë, 2004.

EVANS, J.A: *“Antiquarian researches in Illyricum”*. Part III-IV Westminster 1885.



- EVANS, Sir Artur: *"The Palace of Minos"* 7 vols. London 1930.
- TËRŅAVA, Muhamet: *"Përhapja e islamizmit në territoret e sotme të Kosovës deri në fund të shekullit XVII"*, Prishtinë, m 1982.
- TËRŅAVA, Muhamet: *"Popullësia e Kosovës gjatë shek. XIV-XVI"*, Prishtinë, 1995.
- Tahiri, Abdylidr: *"Hasan Prishinta"*, Prishtinë, 2003.
- Tomić, N. Jovan: *"O Arnautimija u staroj Srbiji i Sandaku"*, Beograd, 1994.
- Trifunovski, Jovan: *"Kumanovska-Preševska Crna Gora"*, Beograd, 1951.
- Trotsky, Leon: *"The Balkan Wars"*, New Yorks, 1980.
- Troebst, Stefan: *"Conflict in Kosovo: Failure of Preventions? An Analytical Documentation 1992-1998"*, Flensburg 1998.
- Trifunovski J: *"Albanskostanovništvo u Makedoniji"*, Beograd, 1997.
- Tucović, Dimitrije: *"Izabranispisi"*, knjiga II (Srbija i Arbanija), Beograd, 1914.
- Thopia, Karl: *"Das Fürstentum Albanien, eine zeitgeschichtliche Studie"*, Budapest, 1916.
- TAFEL, G – THONAS, G: *"Urkunden zur älteren Handels- und Staatsgeschichte der Republik Venedig"*, I-III, Wien, 1856-1857.
- TASIĆ, N: *"Dardanci i dardanskisupstrat (Dardanians and Dardanian Substratum)"*, në "Pyrachmes" 2, Kumanovë 2003.
- TODOROVIĆ, Jovan – CERMANOVIĆ, A: *"Bajnica, naselje vinčanske kulture"*, Beograd, 1961.
- TOMASCHEK, W: *"Wo lag Scupi, die Metropolis von Dardanien? Zur Kunde der Hämus Halbinsel"*, Wien, 1882.
- TOMASCHEK; W: *"Die ältere Thraker"*, Sitzber. Akad. Wien. Bd 128, 1893; I Übersicht der Stämme; Bd. 130; Sprachreste, 1. Glossen aller Art und Götternamen, Bd. 131, 1894.
- TOMOVSKI, Tomo: *"Auf den Spuren der illyrischen Siedlungen Uscana"*, në Živa Antika. XI Shkup, 1963
- TASIĆ, Nikola: *"Žitkovac i neki problemi relativnog hronološkog odnosa neolitskih naselja na Kosovu i dolini Ibra"*, Glasnik SAN, Beograd, 1959.
- THUMB, Adalber: *"Altgriechische Elemente des Albanischen"*, në *"Indo-germanischen Forschungen"*, 1910, Band I.
- TRUHELKA, Ćiro: *"Arheološke beleške iz Juzne Srbije – Grobnica iz Halštatskog doba u Vučjem Dolu, Dardanci"*, në GSDN V/1929.
- THUNMMAN, Johan Erich: *"Untersuchungen über die Geschichte der östlichen Völker"*, Teil 1, Leipzig, 1774.

- THRÄMER: “*Dardanos*”, në Real-Enzyklopädie, IV/1901.
- SALVATORE, Satis, edit: “*The Land of the Etruscans from Prehistory to the Middle Ages*”.
- SALINAS, Roberto: “*Homeric Geography*”, 1992.
- SASSE, Hans-Jürgen: “*Arvanitika. Die albanischen Sprachreste in Griechenland*“, Wiesbaden 1991
- Salihu, Kurtesh: “*Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e autonomitetit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në Jugosllavinë Socialiste*”, Prishtinë, 1984.
- Slijepčevoc, G: “*Srpsko-arbanaški odnosi kroz vekove sa posebnim osvrtom na novije vreme*“, Mynhen, 1974.
- Slišković, Jakov: “*Albanija i Makedonija*”, Sarajevo, 1904.
- SINADINOVSKI, Branislav: “*Shqiptarët ortodoksë në Republikën e Maqedonisë*”, Tetovë, 2016.
- СТОЈАНОВ, Петар: „*Македонија во времето на балканските и Првата сметскавојна (1912-1918)*“, Скопје, 1969.
- Sundhaussen, Holm: “*Experiment Jugoslawien. Vonder Staatsgründung bis zum Staatszerfall*“, Manheim/Laipzig/Wien/Zurich, 1993.
- Surroi, Veton: “*Libri i fluturave*”, Prishtinë, 2011.
- Šišić, E: „*Dokumenti o postanku kraljevine SHS 1914-1918*“, Zagreb, 1928.
- Sufflay, Milan: “*Srbi i Arbabasi. Njihova simbioza u srednjemveku*”, Beograd, 1925.
- Sufflay, Milan: “*Histori e Shqiptarëve të veriut*”, Prishtinë, 2009.
- Schubert, Peter: “*Die albanische Frage und ihr Einfluss auf Sicherheitslage des Balkans*”, Eberhausen, 1996.
- SERGEJEVSKI, D: „*Iz problematike Ilirske umjetnosti*“, Sarajevë, 1965.
- SELISCEV, A.M: “*Slaviankso enaseleniet v Albanii*”, Sofia 1931.
- STEINBAUER, Dieter H: “*Neues Handbuch des Etruskischen*”, St. Katharinen 1999.
- SREJOVIĆ, D: “*Karagacand the problem of the Ethnogenesis of the Dardaniens*”, Beograd, 1973.
- STEPHANUS, Byzantius: “*Ethnicorum quae supersunt. Ex recensione Augusti Meinecki*”, I, Berlin 1849.
- SIMONE, Carlo: “*Ilirët e Jugut. Përpykjet për një kufizim*”, në “*Iliria*”, 1986, 1.
- SISIĆ, F: “*Letopis Popa Dukljanina*“, Zagreb, 1928.
- SPAHIU, Hëna: “*Qyteti Iliro-arbëror i Beratit*”, Tiranë, 1990.
- SPAHIU, Arsim: “*Maqedonasit e vjetër dhe arkeologjia e tyre*”, Tiranë 2013.

STADTMÜLLER; Georg: “*Forschungen zur Albanischen Frühgeschichte*“, Wiesbaden, 1966.

STIPČEVIQ, Aleksandër: “*Ilirët*”, Prishtinë 1968.

STIPČEVIQ, Aleksandër: “*Simbolet e kultit tek Ilirët*”, Prishtinë, 1983.

SREJOVIĆ, D: “*Nekropolja u Donjoj Brnici*”, në Glasnik Muzeja Kosove i Metohije, 4-5/1960.

SUIĆ, Mate: “*Zapadne granice Ilira u svjetlu historijskih izvora*“, në Simpozijum II, pp, 1975.

SOLOVIEV, Aleksander: “*Eine Urkunde des Panhypersebastos Demetrios, Megas Archon von Albanien*”, në “*Byzantinische Zeitschrift*”, XXXIV, 1934.

SOKOLI, Ramadan: “*16 shekuj*”, Tiranë, 1996.

SAYCE, A.H.”*The Hittites: The Story of a Forgotten Empire*”, 2003.

SMITH, W:”*The History of the Peloponnesian War, Translated From The Greek Of Thucydides*”, London 1857.

SVEJEVIĆ, Dragan: “*Balkanski istočnjaci Milana Budimira*”, Beograd, 2001.

SUIĆ, M: “*Ilirski Deus Patrius*”, Beograd, 1961.

Schubert, Peter: “*Zündstoff im Konfliktfeld des Balkans: Die albanische Frage*”, Baden-Baden, 1997.

Schmid, Thomas: “*Krieg im Kosovo*”, Hamburg 1999.

Schuman, Hass Gerhard: “*Anatomi des Agression – Neue Dokumente zu den Kriegzielen der faschistischen Imperialismus zu Zweiten Weltkrieg*“, Ost-Berlin, 1972.

Schwartz, Stephen: “*Kosova - Prejardhja e një lufte*”, Prishtinë, 2006.

Schmitt, Jens Oliver: “*Kosova*”, Prishtinë, 2012.

Schmidt-Endboom, Erich: “*Der Schattenkrieger – Klaus Kinkel und der BND*”, Düsseldorf, 1995.

Schmidt-Endboom, Erich: “*Kosovo-Krieg und Interesse – einseitige Anmerkungen zur Geopolitik*”, Weilheim, 1999.

Shatri, Bajram: “*Arsimi fillor në Kosovë në shekullin XX*”, libri I, II Prishtinë 2009.

Shatri, Muhamet: “*Kosova në luftën e dytë botërore*”, Prishtinë, 1997.

Shatri, Muhamet: “*Kryengritja e përgjithshme shqiptare kundërosmane e vitit 1912*”, Prishtinë, 2018.

Shaw, Stanford, J & Shaw, Ezel Kural: “*Historia e Perandorisë Osmane dhe e Turqisë Moderne*”, Tiranë, 2006.

Ström, Karl-Gustav: “*Jugoslawien ohne Tito*”, Frankfurt, 1979.

SHAFARIK, Johannes: “*Acta Archivi Veneti, spectantio ad historiam Serborum et reliquorum Slavorum Meridionalium*”, I-II, Belgradi, 1860.

SCHNEIDER, Eduard: “*Les Pelasges et leurs discredans*”, Paris 1894.

SCHÜTT, Carl: “*Untersuchunge nur Geschichte der alten Illyrier*”, Breslau, 1910.

SHUFFLAY, Milan: “*Histori e Shqiptarëve të veriut*”, Prishtinë, 2009.

SHUFFLAY, Milan: “*Die Kirchenzustände im vrotürkischen Albanien*”, ne “*Illyrische-albanische Forschungen*”, I, München, 1916.

SHUFFLAY, Milan: “*Städte und Burger Albaniens hauptsächlich während des Mittelalters*”, Wien, 1924.

SHUFFLAY, Milan: “*Acta Albanie*”, I, II.

SHUKRIU (Hoti), Edi: “*Dardania prourbane*”, Pejë, 1996.

SHUKRIU, Edi: “*Ancient Kosova*”, Prishtinë, 2004.

SHKUTRI, Spiro: “*Der Mythos vom Wandervolk der Albaner, Landwirtschaft in der albanischen Gebieten (13-17 Jahrhundert)*”, Wien, 1997.

SHUTERIQI, Dhimitër: “*Arianitet, emri dhe gjenealogjia*”, në “*Studime historike*”, 1965/4.

SCHEVILL, Ferdinand: “*Iliriki, historia dhe qytetërimi*”, Tiranë, 2002.

SCHRAMM, Gottfried: “*Anfänge des albanischen Christentums*”, Freiburg im Breisgau, 1994.

XHUFİ, Pëllumb: “*Krishterimi roman në Shqipëri, shek. VI-XVI*”, në “*Krishterimi ndër shqiptarë*”, Simpozium ndër kombëtar, Tiranë, 16-19 nëntor 1999, Shkodër, 2000.

Vasić, Dragiša: “*Dvameseca u jugoslovenskom Sibiru*”, Beograd, 1921.

Vickers, Miranda/Pettofer, James: “*Albania: from anarchy to a Balkan identity*”, New York, 2000.

Vickers, Miranda: “*Between Serb and Albanian. A History of Kosovo*.” London 1998.

Veliu, R: “*Shtrirja gjeografike dhe lëvizja e numrit të popullsisë shqiptare në Maqedoni*”, Tetovë, 2002.

Verli, Marenglen: “*Kosova sfida Shqiptare në historinë e një shekulli*”, Tiranë, 2007.

Vukmanović, Svetozar- Tempo: “*Memoari I, II 1966-1969*”, Beograd-Zagreb, 1985.

Vllasi, Azem: “*Kosova: fillimi që nuk harrohet*”, Prishtinë, 2017.

Xhemaili, Mustafë: “*HysenTërpeza – një legjendë Kosove*”, publicistikë, Prishtinë.

Welfens, Paul J: “*DerKosvo-Krieg und dieZukunft Europas.*

*Dieplomatie versagen, Kriegs eskalation, Wiederaufbau, Euroland*”, Munih, 1999.

Weller, Marc: “*The Kosovo Cobflikt: Conductand Termination of Hostiltesand the Renewed Searchfor a Sattelment*”, Londër, 1999.

Weller, Marc: “*Shtetësia e kontestuar*”, Prishtinë 2009.

Wied, W: “*Denkschrift überAlabanien*”, manuskript, 1917.

Wilede, Zommy: “*Vonder Untergrundtruppe zur Ordnungsmacht*”, 1999.

Woorwards, Susan: “*Balkan Tragedy: Chaosand Dissolutionaftertge Cold War*”, Ushington, 1995.

Wolf, Winfried: “*Bombengeschäfte. Zur Okonömie des Kosovo-Krieges*”, Hamburg 1996.

Zajmi, Tahir: “*Lidhja e Dytë e Prizrenit dhe lufta heroike e popullit për mbrojtjen e Kosovës*”, Brukselles, 1946.

VULIĆ, Nikola: “*Justiniana Prima*”, 1929.

VULIĆ, Nikola: „*Dardanci*“, në Glas SKA CLV/1953.

ZAVALANI, Tajar: “*Histori e Shqipnis*”, Londër, 1966.

VULPE, Radu: “*Gli Iliri dell’Italiaimperiale romane*”, në Ephem. Docorum, III/1925.

VULPE, Radu: “*Konsiderata rreth origjinës Ilire të popullit shqiptar*”, Kuvendi I i studimeve Ilire 1972. Botoi Akademia e Shkencave e RPSH, Tiranë 1974.

VUKCEVIĆ, Gojko: “*O poreklullira*” I, II, Podgorica 1999.

WALLBANK, F. W: “*Philip V of Macedon*”, Cambrigde 1940.

WALDE, A-POKORNY, J: “*Vergleichen des Wörterbuch der indogermanischen Sprachen*”, I Berlin-Leipzig 1930.

WALSER, G: “*Die Ursachen des ersten römisch-illyrischen Krieges*”, në Historia II/1953.

WILKES, John: “*The Illyrians*”.

WIKEDENS, A.J van: “*Le Pelasgique. Essau sur une langue indo-europeenneprehellenique*”, Louvain, 1952.

WILLETTS, R.F. “*The CivilizationofAncient Crete*”, 1789.

WUTHNOW, H: “*Die semitischen Menschennamen in griechischen Inshriften und PapyridesVorderen Orients*”, Leipzig 1930.

Xylander, Ritter von J: *“Die Schprache der Albanesen oder Schkipetaren”*, Frankfurt, 1835.

ZANINOVIĆ, Marin: *“Iliri i vinova loza”*, Sarajevë, 1976.

ZANINOVIĆ, Marin: *“Ilirsko pleme Dalmati”*, në Godišnjak CBI IV-V-2-3, 1966-1967.

ZIPPEL, Georg: *„Die römische Herrschaft in Illyrien bis auf Augustus“*, Leipzig, 1877.

ZIROJEVIĆ O: *„Vučitrnski i Prizrenski sandžak u svetlosti turskog popisa 1530-1531“*, Prishtinë, 1968.

Зафировски, М: *“Крушевскиот Манифест”*, Скопје, 1948.

Зафировски, М: *„Македонска на ционално праашање и АСНОМ“*, Скопје, 1968.

Zheji, Petro: *“Shqipja dhe sanskritishtja” I, II, Tiranë 2006.*

Zülch, Tilman: *“Etničkočišćenje – Genocid za Veliku Srbiju”*, Sarajevo, 1996.

Zhitia, Skënder: *“Ushtria Çlirimtare e Kosovës – Zona operative e Llapit”*, Prishtinë 2008.

Dokumente: Arkivi i Kosovës, Prishtinë.

Dokumente: AQSH, Tiranë.

Dokumente: Arhiv Jugoslavije (Arkivi i Jugosllavisë), Beograd.

Dokumente: Državni Arhiv Jugoslavije, Beograd.

Dokumente: Arhiv Vojnog Instituta Jugoslavije, Beograd.

Dokumete: Arhiv CK, SKJ, Beograd

## REGJISTRI I EMRAVE

## REGJISTRI I EMRAVE

### A

Aleksandri

Madh:18,22,33,40,45,46,53,54,55,57,60,61,  
62,63,64,66,67,68,69,70,71,72,74,1000,100  
1,1002,1011.

Aleksandri I:58, 416.

Ambisi:19.

Aeropi: 20.

Antara vos, mbret: 39

Apollodori: 52.

Atitani: 52.

Aristoteli: 53,59,60.

Argeasi: 56,57.

Amniastzi: 57.

Alueta II: 57

Arkesas: 57.

Arkesas II: 57.

Amnstasi: 57.

Aminta II. 57.

Aleksandri II: 57.

Aleksandri III: 57.

Adea:66.

Antigoni II: 74.

Antihelosi II: 74.

Antali III: 77.

Androniku: 80,81.

August, perandor: 90,137.

Aliku, Pompari: 94.

Apostoli, Juilian: 126.

Arkadi: 129,184,185.

Anastasi I: 140,141.

Alariku: 130,184.

Apolloni, peshkop: 137.

Ambrozi, shenjt: 147.

Atila: 156.

Arijani, peshkop: 170.

Akomintas, N: 190.

Asparuk: 192.

Ariani, David: 202.

Attaliali, M: 205.

Arslan, Arp: 208.

Aleksi I: 219,220,227, 271.

Aleksi III: 228.

Aleksi IV: 228,239.

Aseni, Jan: 232,235.

Androniku: 245,247,252/

Androniku III Paleologu: 251,252,256.

Ana: 265.

Arianiti, Aleks: 373, 323,324,325,323.

Arianiti, Gjergj: 273,340,343.

Ashik Pasha-Zade:332.

Andreasi: D: 381.

Alfonsi V: 344,357.

Anfi, Islam:539.

Avdyli, Musa:559.

Ataturku, Kemal: 626,766.

Abedini, Zenel: 631,717.

Avniu, Mehmet: 653.

Agushi, Iliaz: 714,660.

Arapi, Anton: 824,825.

Ago, Agaj: 834,834.

Alia, Binak: 439.

Andov, Stojan: 024,929,934.

Azemi, Husamedin:938.

Arami, Sokol: 433.

Aga, Hysen Batusha: 471.

Aga, Abdurrahman: 471.

Aga, Hasan Vranja: 471.

Agë, Sulejman Batusha: 539,588,633,639.

Anastasi: 181.

Adea, Guljem:253.

Annan, Kofi:971.

Andrashi, diplomat:461,466.

Agani, Fehmi:957.

Ajf, J, diplomat:998.

Adhamudhi, Gj:1013.

Ahmeti,

Ali:973,984,996,998,999,1000,1001,1002,1  
003,

Aqimoviq, Milan:798.

Arapi, Anton:824.

Alizoti,Fejzit:797.

Agushi, Jusuf:828.

Arasi,Ruzhdi:767.



Ahmeti, Haxhi Aqif:783.

## **B**

Bafia:36.

Budimir, Milan:27,29.

Besos: 69.

Byzantini, Stefan:51,52,56.

Baseira:67.

Bato, mbret ilir: 77,89.

Bodius, peshkop:121,138,141.

Bonozi, peshkop: 170.

Bryenos, Nicephor:190,207.

Botamioni, Niqifor: 208.

Bazili II (Vasili):201,202,204,207.

Berhtoldi: 681,683,684,692,697,698,719.

Boemundi: 214, 215,219,221.

Bonillon, Gotfren: 220.

Baldvini: 220.

Barbarosa, Fridrif: 222.

Bernardi, peshkop:226.

Baldvini i Flandrisë:228.

Blinishti, Guliem: 242,249.

Balsha II: 255,266,274,276.

Balsha, Gjergj:266,270.

Balsha, Strazimir: 266,276,297.

Balsha III, Gjergji: 276,277,303.

Balsha, Konstantin:304.

Balsha, Regina: 306.

Beu, Ballaban: 271,326.

Brankoviq, Gjurad: 263,268,273

Brankoviq, Vuk (Vlk):296,298,302,  
303,309,351.

Bajaziti, sulltan: 298,300,301,302,303,304.

Beu, Jakup: 321,326.

Beu, Hamza:326.

Beu, Xheladin:430.

Barleti, Marin: 354.

Biem:354.

Buzuku, Gjon:372.

Budi, Pjetër:373.

Bogdani, Pjetër:375.

Bardhi, Frang:375.

Bardhi, Nikollë:378.

Borgjia, Stefan:325.

Braisldorf:500,578.

Bertuçi: 380.

Bajrami, Sherif:783.

Barberino, kardinal:381.

Bonaparti, Napoelon:404,406,408,415.

Bajroni, Xhorxh: 408,446.

Bizmarku:

460,461,462,464,469,747,557,586.

Baba, Hysni:586.

Bej, Fejzo:559.

Butka, Sali: 558,559.

Boletini, Isa:

525,557,586,588,621,622,633,635,638,639,  
644,649,662,663,668,673,675,677,688,690.

Begolli, Mahmut Qerim:558.

Bejta Azem Galica:724,736,737,739,744.

Beu, Rasim:588.

Beu, Jahja: 602.

Bageri, Josif: 602.

Brahimi, Avdyl: 602.

Berisha, Rrok:610.

Buda, Dhimitraq: 610.

Bedriu, Mahmut: 616.

Blloshomi, Hajdar:626.

Binaku, Shaban: 633.

Budakova, Hysen: 635,639,699.

Budakova, Hasan: 635,649.

Beu, Zenel: 639.

Beu, Sadedin: 641,648.

Bellkameni, Spiro: 645,669.

Bacaj, Sadik:648.

Bekonsfild, lord: 656.

Buqi, dom Luigj: 657.

Binaku, Qerim: 662.

Basha, Nexhip:828.

Begolli, Xhavit:828.

Bllaca, Hasan:664.

Bejtaga, Ahmet: 667.

Beu, Talat: 668.

Bacaj, Sokol: 669.

Boletini, Tafil:749.

Boletini, Bajazit:799.

Boletini, Asllan:826.

Berati, Dhimitër:699.

Beluli, Jetish:733.  
Beluli, Halil:792.  
Bardhi, Rexhë:733.  
Begolli, Qerim:799.  
Braha, Neriman:804.  
Biçoku, Ibrahim:822.  
Besel, von, gjeneral:823.  
Bllaca, Qazim:826.  
Blyta, Aqif:827,828.  
Basha, Nexhip:828.  
Bakalli,  
Mahmut:913,914,922,925,926,927,935.

Buekoviç, Memish:842.  
Berisha, Hamdi:842.  
Balla, Jonuz:843.  
Billalli, Hasani:847.  
Brezeshta, Halil bej:556.  
Bajraktari, Muharrem:849.  
Bakariq, Vladimir:852,929.  
Brezhnjve, Leonid:881.  
Bogdan, Bogdanoviç: 935.  
Boshkovski: 980.  
Berisha, Esat:828.

## C

Cani, Osman:848.  
Corinthius: 35.  
Charles, A:36.  
Chryse:36.  
Clark, S: 36.  
Cakrani, Hajredin:699.  
Clinton, historian: 38.  
Cezari Julius: 87,88.  
Cami, Dan:667.  
Cali, Pandeli:666.  
Cortenji, Pjetër: 231.  
Crnojeviq, Gjurasg: 365.  
Crnojeviq, Arseni III: 385,387,420.  
Crvenkovski,  
Krste:903,907,908,919,934,937.  
Curri, Hysni: 616.  
Curri, Bajram:  
471,494,558,624,649,664,665,666,677,678,  
690,699.  
Curri, Shaqir:799/  
Cvetkoviç, Dragisha:799.  
Cilika, Grigor:610.  
Care, Naim: 688744,  
Cale, Pandeli:645,699.  
Ceroviç, qetnik:739.

## Ç

Çabej, Eqrem:30.  
Çavdarbasha, Shaqir:639.  
Çeli, Pjetër:666.

Belisari:155,156.  
Bej, Sadullah:467,467.  
Boçari, Marko:470,562.  
Bej, Sulejman:471.  
Bej, Tefik:471.  
Bej, Halit, Tetova:471.  
Bej, Zenel:494.  
Bej, Xhemaui:549.  
Brezeshta, Halil:554,556.  
Biticku, Jaha:556.  
Bylykbashi, Etem:784.  
Bakalli, Qazim:744.  
Branay, Sesil:713.  
Borkoviç, Olimpije:736.  
Balshe, kolonel:737.  
Begolli, Rakip Kaje:744.  
Bajrami, Latif:758.  
Bushi, Mehmet:842,845,857.  
Berisha, Esat:842.

Çe Gevara:892.  
Çubrilloviq,  
Vasa:774,775,776,777,778,779,784,788,83  
7,838,839,869,877.  
Çaçani, Adil:916.  
Çejku, Agim:958.  
Çeli, Pjetër: 664.  
Çeku, Mentor:828.

## D

Diodori, filozof:19.  
Dardani:25,26,34.  
Dardanus:25,36.  
Dardanim: 36,37.  
Dardani, Niketë:146,147,174.  
Dimas:36.  
Dariusi:57,61,67,69.  
Demetri II:74.  
Dozoni, Antigoni:75,6,77.  
Dashi, Hasa:828.  
Diokleciani,  
perandor:92,110,14,120,122,123,124,129,1  
32,136,150,151,152,153,154,174,180,18211  
93,234.  
Dushani,  
Stefan:178,180,206,240,250,252,253,255,2  
56,258,259,260,263,280,291,360,384.  
Dukas II. Mihael: 227.  
Donaldi, Henrik:227,230.  
Donaldo, Andrea: 263.  
Despina: 273.  
Dejanoviq, despot: 301.  
Dukagjini, Lekë: 279,281,354,365.  
Dukagjini, Progon:303,366.  
Duraku, Emin:802,803,804.  
Dejvis, Edmond:808,809.  
Dervishi, Mustafë:810.  
Dishnica, Imer:810,812,815,816,820.  
Dosti,Hasan.810.  
Dodbiba, Sokol:824.  
Dukagjini, Tanush:303.  
Dukagjini, Nikollë:323,324,325,354,356.  
Dukagjini, Gjergj:340.  
Dukagjini, Pal: 378.

Durrsaku, Grigor:393.  
De Rada, Jeronim:503,609.  
De Gjergjisi: 547.  
Doda, Prend Biba: 442,444,473.  
Dedë, Gjo  
Luli:639,643,644,645,648,649,650.  
Dino, bej Vesel: 447, 454.  
Deljanis, Therodoos: 463.  
Dinoshi, A:472.  
Doçi, Preng: 488.  
Domeniku, N:538  
Daliu, Hafiz Ibrahim:603.  
Durrsaku, Gjergj: 609.  
Daci, Ramiz: 619.  
Dushi, Hajdra:804.  
Draga, Ali Bej:  
Daklani, Bajram: 644,660. 665,677,744.  
Draga, Ajdin:699.  
Devaja, Ismail, Haki:667.  
Devaja, Mehmet:828.  
Deljanis,Theodor:465.  
Deva, Veli:897,813,914.  
Draga, Nexhip:  
567,603,604,616,620,639,663,664,673,690,  
691,694,782.  
Draga, Ferat  
Aliu:783,786,787,790,793,794,799.  
Deva, Xhafer:822,824,826,835,737,842.  
Durra, Avdyl:840.  
Dauti, Rexhep:845.  
Durham, Edit:887.  
Demaçi, Adem: 958.  
Doda, Xhevdet:804.  
Dibra, Fuat:824,833.

## E

Elektra:35,43.  
Europidi:39.  
Eskili:34,50,52.  
Euridika:57  
Eudokia, Augusta:130.  
Euzebio, peshkop:139.  
Eustahi, peshkop:142.  
Eluri, Tomitej:149.

Efesi, poet:66.  
 Ertogulli:293.  
 Emanuelli Viktor III: 805.  
 Engjëlli, Teodoro Komneni:231,232,235.  
 Engjëlli, Niqifor:263,266,267.  
 Efendia, Daut:469,470.  
 Efendia, Sulejman;783.  
 Evrenozi, Isa bej:307,324,325.  
 Ejupi, Hysniqemal:845.  
 Ejupi, Ismajl:901.  
 Enveri, Ismail:586,592.  
 Engel, Eliot:987.  
 Erebaba, Jashar:602.  
 Efendia, Hoxha Vildan:610,613.  
 Efendia, Mahmut Mahir:698.  
 Elbasani, Sali Hoxhë:664.  
 Efremov, Gjorgji:992.  
 Elezi, Isuf:744.

## F

Frashëri, Naim:573,576,602,614.  
 Frashëri,  
 Sami:451,476,489,501,502,504,505,506,509,  
 515,602,607,609,687,1013.  
 Frashëri,  
 Abdyl:444,446,447,448,449,455,456,471,573.  
 Frashëri,  
 Mit'hat:599,602,610,651,688,699,808,811.  
 Frashëri, Vehbi:800,822,849.  
 Frashëri, Mehdi:800,824,846,849.  
 Frashëri, Fahri:  
 Frashëri, Kristo:30,328.  
 Frashëri, Shefqet:610.  
 Fazuli, poet:576.  
 Fishta, Gjergj:609.  
 Filipi II i  
 Maqedonisë:47,57,58,59,60,61,71,74,75.  
 Filipi V:74,76,77,78,79.  
 Fari, Gai:83  
 Falmerajeri, historian: 356,887.  
 Foigt:356.  
 Finlay, G: 422.  
 Flori, shenjtor:137,145,167.

Foka, peshkop:142,159,162.  
 Fatim, kalif:220.  
 Filipi I i Tarentit:248,249,251.  
 Frangu, Dhimitër:344.  
 Frederiku, II:357.  
 Ferdinandi, Franc, princ:65,718  
 Feridi, Mehmet:670.  
 Frizi, Nimon:744.  
 Frowick,diplomat:983,998,1000,1001,1002,  
 1003.  
 Fisher, Joshka:987,995.  
 Foley, David:998,1003.  
 Ferri, Hasan:744.  
 Feri, Shemsi:828.  
 Fyrstenberger,princ:696.

## G

Gauani:20.  
 Gamer:36.  
 Glauku, mbret:64.  
 Genci, mbret:79,80,83,85,88.  
 Gai, Fani:83.  
 Gali, Luc Anici:80,82.  
 Gai, Mark F:87.  
 Garibaldi, Xhuzepe:643.  
 Garibaldi, Ricoti:644.  
 Gemini, F:88.  
 Germaniku:90.  
 Graciani, perandor:109,140.  
 Galeri, perandor:133,174.  
 Gazdinci,peshkop: 141.  
 Gergenci, peshkop: 146.  
 Germani: 146.  
 Garashanin, I:395,409,464,770.  
 Gashi, Bajram:828.  
 Gëte, poet:423.  
 Goreshkov,diplomat:461,464,465.  
 Guiskardi, Robert:212,213,214,215,220.  
 Grados, patrik:216.  
 Gazi, Malik, emir: 220.  
 Gostivari, Xhemë: 843.  
 Grigori, Nikolla: 257.  
 Gropa, Zaharia:266,349.

Greblanoviq, Lazar:290.  
Gurezi, Selino:470.  
Goluhovski,diplomat:517,525,537,557.  
Gazi, Mihail:313.  
Genadiev:561.  
Gabina,Aruel:87.  
Gurakuqi, Luigj:603,643,648,650,695,699.  
Germeni, Thunika:616,637.  
Giano, kont:797.  
Grey, Eduard ser:707.  
Gocadini, kardinal:380.  
Grinziger,baron:549.  
Grameno, Mihael:601,637.  
Gllavica, Adem:844,846,847.  
Gashi, Luan:846.  
Gopçeviq, Spoiridon:883.  
Grini:887.  
Gligorov: Kiro:919,943,952,955.  
Georgievski, Vlado:981,982,986.  
Govori, Bajram:734.

## GJ

Gjurici, Daniel:355.  
Gjini, Mark:379.  
Gjuka, Sali:688,699.  
Gjeti, Gjelosh Marash:643.  
Gjakova,Ibrahim:667,799.Gjakova,  
Murat:744.  
Gjorgjeviq J:728.  
Gjorgjeviq, Dragutin:806.  
Gjinushi, Mustafa:807,815,816.  
Gjilani, Mulla Idriz:849.  
Gjylbehari, Musa:824.  
Gjuriq, Pavle:832.  
Gjinaj, Bedri:827.  
Gjinali,Avni:671,673.

## H

Hahn, J. G:47,54.  
Hana, Xheladin:804.  
Hamza, Xhevdet:804.  
Halili, Shaqir:792.  
Hakiu, Ibrahim:668.  
Hadrian, perandor:167.

Herodoti,  
filozof:20,21,29,52,62,181.Hammandi:28.  
Homeri:28,33,34,38,43,50,51,,105,284.  
Haddington, W:465.  
Hesiodi:34,50,105.  
Harmonia:35,36.  
Helena: 39.  
Hefistios:70.  
Herkuli:39.  
Honorii:129,140.  
Hanibal:76,77,79.  
Herakliti, perandor:  
130,159,161,162,163,164,165,173,177,185,  
186,187,188,180,192,198.  
Herakleu:145.  
Harnaku:138.  
Hizi, peshkop:141.  
Hadrian, perandor:167.  
Heneriku V:222,223,232.  
Hohenshtaufen: 237.  
Hreblanoviq, Lazar:296,301.  
Hull,C:808.  
Horvat, Ivan:297.  
Hibert:815.  
Hirsh:468.  
Hasani, Sheh:826.  
Halkondili, kronist:324.  
Hunijadi, Jon:335,351,390.  
Hudington:463.  
Hirsh, baron:466.  
Husamedini J:472.  
Hoti, Miriman: 473.  
Hasfield, diplomat:474,475,479,480.  
Hamidi,  
sulltan:483,487,488,491,493,494,495,507,5  
08,509,511,519,521,523,524,528,529,535,5  
50,535,365,566,579,580,584,585,587,589,6  
19,624,628,633,638,653,660,626,674,675,6  
78.  
Hima, Dervish:495,504,595,600,616.  
Hafizi, Ibrahim:619.  
Haziri, Bajram:828.  
Hamzagaj, Vehbi:828.  
Hoxha, Hafiz Ali: 637,661.

Hoxha, Sait:691,699.  
Haxhi, Ali Elbasani: 618.  
Hyseni, Hilmi, vezir: 624.  
Hamitim, Reshat, sulltan:625,646.  
Hitler, Adolf:794,821,823,834.  
Hasani, Sheh: 825.  
Hasni, Sinan:934,935.  
Hoxhë, Hafiz Ibrahimimi:  
Hoxha, Fadil: 804,  
Hoxha,Enver:805,815,816,817,818,820,829  
,869,870,847,877,885,915,916,917.  
Hoxha, Fadil:804,902,903,913,922,934,935.  
Haliti, Nevzat:953.  
Haliti, Xhavit:996.  
Hollbruk, Riçard:497.  
Haradinaj, Ramush:998.  
Hoxha, Din:842.  
Hoxha, Nehat:853.  
Haxhiu, Bejtullah:828.  
Hotla, Sylë:842,845,846.

## I

Ideus:36.  
Iliri (Ilios):36,43,44.  
Isokrati:59,60,105.  
Isaku III:225,227.  
Irena: 173,305.  
Ibrahimi, Nuredin: 845.  
Ibra, Ali:455.  
Ippen, konsull austriak:430,578,887,888.  
Ivanaj, Nikollë:643,645.  
Ivanov, diplomat rus:979.  
Ilo, Spiro:699.  
Imeri, Jusuf:794.  
Imeri,Imer:1005,1007.  
Isufi, Sali:783.  
Iden:808.

## J

Jaha, Izet:664.  
Jankoviq, Bozhidar:686.  
Jokl, Norbert:30  
Jafeti:36.  
Jovan, peshkop:36.

Justini, perandor:53,155.  
Justiniani,  
perandor:114,134,143,147,149,150,154,156  
,157,158,159,160,161,162,164,170,172,181,  
185,196,198,225,235,280,181,103,104.  
Jordani:145.  
Johani i Kapadokisë:155  
Justinaiani II: 159.  
Juliani, perandor: 168,169.  
Jezui (Krishti):169.  
Joviniani:256.  
Joniom, Dhimitër:296.  
Jorga, Nikolla:359.  
Jorga, Josif:828.  
Jozef, princ 536.  
Jozefi, Franc II:693,705.  
Jonuzi,Nebi:845.  
Jastrebov,I:902.  
Jashari, Kaqusha:932.  
Jovanoviq, Pavle:806.  
Jovanoviq, Bllazha:800.  
Jelinac.413.

## K

Kadmi:35,36,44.  
Kamarda, Dhimitër:30.  
Karabegu, Ismet:784.  
Karagjorgje, Petrovq: 387,414.  
Karagjorgjeviq, mbret: 492,755.  
Kittin:36.  
Khursavi, I:557,163.  
Kryeziu, Riza:664,668,673,678.  
Kleçka, Sefë Neziri:664.  
Korioni, Gai Skribon: 86.  
Krispi, Xh:55.  
Kliti:64.  
Kosomos: 136.  
Konduriolli, Stefan:645.  
Kelmendi, Ismet bej:783.  
Konstandini i  
Madh:perndor:106,108,114,120,121,123,12  
4,125,126,129,133,135,136,140,141,142,15  
0,151,165,167,168,170,182,196,1013,1014.  
Konstandin, Tiber: 159.

Konstandini IV:102.  
 Konstandini V: 173.  
 Karli i madh: 177.  
 Khursavi I:157,161,163.  
 Karakalla:109.  
 Konstanci:126.  
 Klorig, Konstandin:133.  
 Klementi i Ohrit:196,197.  
 Kledresos, G:208.  
 Komneni, Aleks:  
 207,210,212,214,215,216,217,218,219.  
 Komnena, Ana:271.  
 Konstandini, knjaz i Velbuzhit:290.  
 Kantakuzeni, perador:221,257,286.  
 Kantzakuzeni V:287,288.  
 Karli i parë,  
 Anzhu:236,237,238,241,242,244,249,260,3  
 47,358,367.  
 Kantakuzeni, Tomas:305.  
 Kastrioti, Gjon:  
 282,283,304,305,321,322,323,337,365,366.  
 Kastrioti, Angjelina:273.  
 Kastrioti, Gjergj –  
 Skënderbeu:273,326,327,331,332,333,334,4  
 45,358,339,349,351,352,353,355,356,360,3  
 61,362,363.  
 Kastrioti, Reposht: 282.  
 Kastrioti, Vojsava:343.  
 Kastrioti, Gjergji i parë:366.  
 Kastrioti, Donika:343.  
 Kopiliqi (Kopili) Milesh (Milosh):297,298.  
 Kopricka, Xhelal:699.  
 Kadria, Hoxhë Prishtina:743,744.  
 Krasniqi, Mark:328.  
 Kazazi, Gjon Nikollë:372.  
 Krispi, Sepe:372.  
 Kavaliotu, Theodor:391.  
 Kandis, B:564.  
 Kallakotroni, Th:432.  
 Kunnduriti, G:432.  
 Korenica, Ahmet:454.  
 Konica, Faik:485,688.  
 Kryeziu, Riza:491.  
 Kolonja, Shahin:561,562,620.

Kazazis, Neoklis:562,563.  
 Kylçe, Sulejma:567.  
 Kristoforidhi, Konstandin:602.  
 Krispi, Josif: 608.  
 Kaçori, Nikollë:610.  
 Karahoda, Qemal:828.  
 Kryeziu, Sulejman:828.  
 Kurtaga, Adem:828.  
 Kolonja, Sulejman:670.  
 Kruja, Mustafë Aziz:654.  
 Kurti, Sadik:794.  
 Keitel, gjeneral:797.  
 Kupi, Abaz:810.  
 Krasniqi, Rexhep:799.  
 Kolaj, Prenk:643.  
 Kolishevski, Lazar:  
 Kardel, Eduard:840,852,836,839.  
 Kolishevski,  
 Lazar:840,863,917,925,928,929,934,937.  
 Kurteshi, Hajdar:845.  
 Kajolli, Hazir:846.  
 Kelmendi, Ibrahim prof:846.  
 Kabashi, Hasan:850.  
 K, Veli:883.  
 Katarxhiev:849.  
 Kamarda, Dhimitër:1013.

## L

Lamani, Dhimitër:918.  
 Lykani:19,52.  
 Lybke, M:30.  
 Lauri, martir:145.  
 Longari: 61,74,77.  
 Libohova, Ismail:667.  
 Lippich:887.  
 Livi, Tit:75,79.  
 Leoni I:145,149.  
 Leoni III:135,150,156,166,171,173.  
 Leon i IV:193.  
 Lauri:137,145.  
 Ludoviku, mbret:257,289.  
 Lajbnic, filozof gjerman:391.  
 Lazareviq, Vuk, despot:276,304.  
 Lazareviq, Stefan, despot:306.

Layordi, Henri:432.  
Ludvig, Emil:460.  
Latini, Todea:471.  
Leskoviku, Hilmi:601.  
Libohova, Myfit bej:654,671,674.  
Lotiq:792.  
Ludwig, Radnay von:698.  
Limoni, Xhavit:  
Lusha, Ismet:828.  
Luzha, Asim:794.

## LL

Lluka, Mustafë: 139.

## Y

Ypi, Ferat:616.  
Ypsilant:608.  
Ymeri, Rrustem:828.

## M

Makedoni:19,52,56.  
Mikloshiq:30.  
Meyer, Gustav:30.  
Magogu:36.  
Meschohi:36.  
Mouni, mbret:79.  
Mendoni, mbret:39.  
Memoni: 67.  
Mouni:79.  
Maksimi:137,145.  
Maklin, Bill:808.  
Maurici:159,160,161,162.  
Mistik, Nikolla:195.  
Miliq, Krsta:787.  
Metodi:196,197,198.  
Maniaku, Grigor:207.  
Mihali i Dioklesë:214.  
Marazini, Tomas:230.  
Murati, sulltan:287,288,297.  
Murati II,  
sulltan:306,307,325,330,340,345,356,373.  
Mehmeti I, sulltan:304,305,307,330.  
Mahmudi, II, sulltan:311,400,432,574.  
Mehmeti, II, sulltan:306,309,310,333.

Mexhidi, Abdyl, sulltan:494.  
Mehmeti, Rashit, sulltan V:633.  
Mehmeti, Halil:664.  
Mustafa, sanxhakbej:332.  
Mustafa, Haxhi:399,413.  
Mustafa, Vesel:400.  
Mavroviev:517,525.  
Mejza, Hasan:603.  
Marashi, Engjëll:608.  
Mjeda, Ndre:609,657.  
Mavrakordatos:423.  
Makushev:358.  
Mono, Bajram:662.  
Mole, Dhimitër:610.  
Mitko, Thimi:426.  
Mosi, Hil:610.  
Murzufski, duka:  
Manueli III:233.  
Magneci:126.  
Mameli:233.  
Muzaka, Gjin:240,242.  
Muzaka, Karl:  
Muzaka, Manuel:251.  
Muzaka, Andrea II:272.  
Muzaka, Teodor III:251,252,254,272,305.  
Muzaka, Konstandin:232.  
Muzaka, Gjon:  
Muzaka, Maria:273.  
Musai, sulltan:304,305.  
Mbroja, Dhimitër:699.  
Mirçea, V:297.  
Millojeviq, kolonel:660.  
Milanoviq:660.  
Muka, Koqo:825.  
Mjeda, Luk Simon:826,828.  
Mitrovica, Rexhep:696,699,799,828,831.  
Mitrovica, Xhelal:828.  
Mahmuti, Mehmet Ali:784.  
Mahmutbegu, Sefedin:784.  
Marana, Azem:847.  
Mamerllaku, Adem:794.  
Millutinoviq, Iva:800,815.  
Mugosha, Dushan:800,801,805,814,815,816,  
818,820,853.



Mitrev, Gjoko:899.  
Mehmeti, Valon:901.  
Mojsov, Lazar:924,925,929,937.  
Maz'har, Sopi:828.  
Millan, Mickoviq:806.  
Mihajloviq, Drazha:829.  
Molotov:808.  
Mosi,Hil:643.  
Morina, Rrahman:938.  
Musolini:810.  
Maçek, V:793.  
Maklin, Bill:808.  
Millosheviq,  
Slobodan:935,935,936,937,938,939,941,94  
4,955,956.

## N

Nazika, K:84.  
Naserti:155,156.  
Nemanja,  
Stefan: 177,206,223,224,225,226,261,278,2  
93.  
Nemanja, Vukan:223  
Naumi:197.  
Niqifori, despot:242.  
Negovani: Kristo:559.  
Naçi, Naum:599.  
Nosi, Lef:699.  
Noli, Fan Stilian:348,38,688.  
Nikolla II, car:424,436,566.  
Napoelon, Bonaparti:438.  
Neshiq, Angjekjo:725.  
Naço, Nikolla:485.  
Nediq, Milan:796.  
Nikolla, mbret i Malit të Zi:640,641.  
Nazemi, Hysni:670.  
Nojbaher, H:824.  
Nazif, bej:783.  
Nivica, Sali:744  
Nimani, Elhami:804.  
Nimani, Xhavit:804.  
Nasi, Lef:602,637, 824,825.  
Nikoçi, Ismail Haki:744.  
Nikas, A:808.

Nushi, Gogo:811.  
Nediq, Milan:825.

## NJ

Njaziu, Ahmet,  
kolonel:569,585,587,592,595,624.

## O

Osmani, Bedri:825.  
Osmani, Kemajl:783.  
Omari, Bahri:825.  
Oana, Halim:847.  
Oven, lord:993,998.  
Osirisi:19.  
Ostir:30.  
Oktaviani, August:88,89.  
Orbin, Mario:179.  
Ohrani, sulltan:286.  
Osmani I, sulltan:293.  
Obrenoviq, Millosh:416.  
Otto, i Bavarisë:425.  
Obrenoviq, Dositej:412  
Osmani, Xheladin:472.  
Orllov,konsul:547.  
Okllani, Hysen Agë:783.  
Osteni, Gëzim:969,973.

## P

Predika: 20.  
Pizistrati:28,38.  
Priami, mbret: 38,39.188.  
Pirro Molosi, mbret:45, 1013  
Predika II:58,61  
Ptolemeu III:73.  
Ptolemeu:63,71,73,105,113.  
Ptolemeu IV:71.  
Pindari, plak: 64,65.  
Parasysaste: 70.  
Plutarku X: 71.  
Perseu: 79,80.  
Polibi: 84.  
Pinesi, mbret:89,90.  
Pleurati, mbret:77,80.

Plini:105,137.  
 Prokopi i Cezaresë:113,114.  
 Pali, Shën:136,137.  
 Protera, plaku:149.  
 Porphyra:179.  
 Prokuli:137,167.  
 Paleologu, Mihal:233,234,239,341,243,302.  
 Paleologu, Simon Urosh:265.  
 Paleologu, Jovan:288,289,334.  
 Paleologu, Andronik II:294.  
 Paleologu, Andronik III:294.  
 Preluboviq, despoit:267.  
 Papa, Leoni: 131,140,141.  
 Papa, Gregori:221.  
 Papa, Gregori X:149,238,242.  
 Papa, Grigori XI:270.  
 Papa, Gezali I:148.  
 Papa, Johani XXII:251,262.  
 Papa, Klementi III:222.  
 Papa Klementi IX:375.  
 Papa, Klementi V:261,263.  
 Papa, Inocenti I:148.  
 Papa, Inocenti III:223,226,262.  
 Papa, Inocenti IV:236.  
 Papa, Inocenti V:261.  
 Papa, Urban V:289.  
 Papam Bonifici IX:303.  
 Papa, Bonifici III: 160.  
 Papa, Eugjeni IV:334,346.  
 Papa, Piu II:350.  
 Papa, Nikolla V:359.  
 Papa, Kalinski III:357.  
 Papa, Pali V:380.  
 Papa, Benedikti III:222.  
 Papa, Honori III:232,262,  
 Pauell, Kolin:986,988.  
 Parinas, Pal:372.  
 Pikolomini, gjeneral:376,384.  
 Plezha, Toma:378.  
 Pazazavanaogllu, Osman  
 pasha:395,401,403.  
 Pauluci, kolonel:415.  
 Prodani,Haxhi:417.  
 Prishtina,  
 Hasan:452,455,524,568,589,604,614,620,6  
 21,629,630,632,633,651,652,653,654,656,6  
 59,660,671,672,673,674,575,678,689,690,6  
 91,694,695,696,717,718,735,743,745,771,9  
 62,1015.  
 Prishtina, Zija:454.  
 Prishtina, Danush bej:670.  
 Prishtina, Qamil:799.  
 Prizreni, Ymer Haxhi:454,455.  
 Prizreni, Shaban bej:455.  
 Pjetri,mbret:685.  
 Pavli,princ:741.  
 Pasha, Mahmut  
 Bushatliu:395,401,404,405,406,407.  
 Pasha, Ali  
 Tepelena:395,401,407,408,421,422,423,427  
 ,429,515.  
 Pasha, Hafiz:415,441.  
 Pasha, Sinan:362.  
 Pasha, Sulejman:365.  
 Pasha, Muhamed Ali:424,425.  
 Pasha, Hivzi:429,430.  
 Pasha, Hysen:429.  
 Pasha, Omer:432.  
 Pasha, Mehmed Rashid:334.  
 Pasha, Mahmut Tuzlla:441.  
 Pasha, Osman:446.  
 Pasha, Abedin Dino:452.  
 Pasha, Omer Vrioni:452.  
 Pasha, Mahmut Biçoku:452.  
 Pasha, Iliaz Dibra:454,456.  
 Pasha, Mustafë Vlora:454,471.  
 Pasha, Avdullah Dreni:425.  
 Pasha Maxharr (Mehmedali  
 Pasha):464,466,467.  
 Pasha, Gucia Ali:452.  
 Pasha, Muhamedin:471.  
 Pasha, Rrustem: 472.  
 Pasha, Hajredin:270.  
 Pasha,Karatheodor:747.  
 Pasha, Dëvish:491.  
 Pasha, Said:526,591,668,679.  
 Pasha, Hilmi:527,533,536,546.

Pasha, Shaqir:539.  
Pasha, Mahmut  
Shefqet:558,642,626,627,628,632,637,663,  
669,670.  
Pasha, Mahmut Feri:591.  
Pasha, Haki:617.  
Pasha, Xhavit:622,629,630,631,632,669.  
Pasha, Ferid:629.  
Pasha, Fuat:629.  
Pasha, Mit'hat:629.  
Pasha, Sulejman:632,633.  
Pasha, Aziz:632,633.  
Pasha, Mehmet:632,633.  
Pasha, Haki:633,634.  
Pasha, Dërgut  
Shefqet:635,636,637,639,641,643,645,647,  
660,662,664,665,668,669,670.  
Pasha, Ismail Fadil:663.  
Pasha, Gazi Ahmet  
Myftar:670,671,673,674,675,677,678,681,7  
71.  
Pasha, Mehmet Deralla:699.  
Pasha,  
Ibrahim:671,672,673,675,677,681,771,  
Pasha Rashid Akif: 671.  
Pasha, Hasan Riza:712.  
Panjevac, Borivoje:774.  
Peza, Myslim:810,811.  
Pasha, Shemsi:525,567.  
Pashiq,  
Nikolla:755,775,780,781,782,787,788.  
Pavllacini:655,680.  
Popoviq,  
Milladin:800,801,814,815,816,818,820.  
Popoviq, Zhivka:725  
Pejani,  
Bedri:616,620,654,688,699,744,790,799,82  
8.  
Panariti, Tefik:616.  
Prebiqueviq, Svetozar:781.  
Prishtina, Hoxhë:783.  
Popoviq, Miladin:800,815,840.  
Popoviq,Koqa:852.  
Pejçinoviq, Jovo:918.

## Q

Qosja, Rexhep:997.  
Dosiq, Dobrica:912,953.  
Quku, Faik:810.  
Qirili:169,197,198.  
Qazim, Abdyli:217.  
Qemali,  
Ismail:507,509,510,511,560,563,564,595,5  
96,620,621,623,629,630,631,634,647,650,6  
53,654,655,658,659,660,674,675,684,694,6  
95,696,697,698,699,709,717.  
Qiriazhi, Gjergj:556,599,610,616.

## R

Radiq, Stjepan: 791.  
Rajiq,Jovan:413.  
Ribezo:30.  
Roksana:69.  
Rehtor, M:190.  
Rastislav:196.  
Radovic,J.M:466.  
Radofikin:416.  
Rozher, mbret:213.  
Rajmondi,kont:218.  
Rober i Flandresë:218.  
Rajmoni i Tuluzes.219.  
Rober, Anzhu:254.  
Raspasani Toma:385.  
Radiq, Stjepan:788,791.  
Ridëll, Riçard:808.  
Riza, Skënder:387.  
Radovani, Gjorgji:405.  
Ristiq, Jovan:463,464,466.  
Rodney J:465.  
Radulin:479,480,481.  
Riter, Henri:538.  
Roghei, Miller:538.  
Ribentrip,von:797,821,822.  
eçaku, Iliaz:733.  
Rugova, Ibrahim:953,984.  
Rama Sadik  
Gjurgjeviku:660,662,665,677,744.  
Ramadani, Hixhet:900.

Robertson, Xhorxh:983,984.  
Rudi, Hysen:847.  
Rankoviq,  
Aleksandër:852,890,892,894,896,898,904.

## **Rr**

Rrota, Justin:373.

## **S**

Straboni:20,21,47,48,49,50,51,54,105.  
Sofokliu:34.  
Skylaks:42.  
Sturzi:55.  
Sirmas, mbret tribal:63.  
Sabato:892.  
Statera:67.  
Stariera:70.  
Skribon, Gai:142.  
Sabijan, peshkop:142.  
Samuili:14,200.  
Senirames, mbret:70.  
Simeoni  
mbret:177,193,194,196,197,260,256.  
Sulejmani,bej:326.  
Simbshen von:417.  
Stratford,lord:438.  
Sylly, Hugo:242.  
Spata, Pal:268.  
Spahiu, Shuajip:457.  
Sadiku, Ramiz:800.  
Spata, Jakup: 268.  
Saad-ed-Din, historian:332.  
Sadedin, Shehu:782.  
Spani, Pjetër:340.  
Sekendos: 387.  
Suma, M: 388.  
Selimi III,  
Sulltan:379,398,400,402,403,406,412,413.  
Skalinthas, S:449.  
Solsberi:463,656.  
Sandanski, Janke: 520.  
Skiro, Gjon: 608.  
Sarafov:680.  
Seferi, Idriz:635,636,649.

Seferi, Kasim:691.  
Siliqi, Risto:643.  
Stojadinoviq, M:790,792.  
Simkov, Atoni:808.  
Stefani, Tomas:808.  
Smajll:815.  
Skënderi, Qemal:846,847.  
Sermaxhaj, Haki Efendi:847.  
Stalin ,J.V:868.  
Saimi, S:895.  
Stamboliq, Ivan:935.  
Solana, Havier:983,957,958,959,860.  
Surroi, Veton:997,998,999,1000,1001,1003.

## **Sh**

Sherifi, Efendi Dibra:699.  
Shën, Ambrozi:  
Shabanpasha, Mahmut:828.  
Shahini, princ:163.  
Shahini, Lala:289.  
Shpata Gjin Bue, princ:267.  
Shufflay, Milan:266.  
Shkupi, Jashar bej:455.  
Shuvalov, princ rus:462,463.  
Shabani, Ramadan:660.  
Shabani, Haxhi:456.  
Shiroe,Karvadhi:163.  
Shefkiu, Omer:473.  
Schanderle, D:477,478.  
Sherifi, Mehmet:494.  
Shpendi, Mehmet:643.  
Shuteriqi, Simon:603.  
Shefqeti, Mehmet:668.  
Shehu, Halim:825.  
Shehu, Musa:826,827,828.  
Shehu, Maksut:959.  
Shukriu, Ali:800, 934,938.  
Sheshel, Vojisllav:954.  
Shpendi, Mehmet:639.  
Schania, gjeneral:657.

## **T**

Tomunidi:20,21.

Termenidi: 20,21.  
 Tito, Josip Broz:  
 800,803,804,814,820,838,851,852,853,854,  
 856,857,858,859,862,863,864,865,869,870,  
 871,881,890,891,892,894,896,903,905,906,  
 907,912,913,914,915,916,917,918,922,925,  
 926,927,928,930,938,952,961,10011,1016.  
 Turkididi:49.62,105.  
 Teodakis, kryemintër grek:566.  
 Tenker, mbret:25,26.  
 Toglavini, C:30.  
 Tubal:36.  
 Tirusi:36.  
 Tiberi:90.  
 Tarsh, Sh:36.  
 Troji:37.  
 Tesproti:52.  
 Teuta, mbretëshë:79,80.  
 Turer:94.  
 Teodosi I:128,129,140,169,209.  
 Teodosi II:130.  
 Tertuliani:137.  
 Teodoriku:156,182,185,233.  
 Tacitiusi:187.  
 Tankredi:219,221.  
 Timurglengu:304.  
 Torzelo, G:346.  
 Todhri, Dhaskal:395,609.  
 Tahiri, Sulejman:447.  
 Tahiri, Osman:471.  
 Temo, Ibrahim:485,568,595,631.  
 Topulli,  
 Bajo:556,558,559,560,561,562,565,585,610  
 Toptani, Refki:610.  
 Toptani, Esad  
 Pasha:625,654,670,671,673,712,713,718,72  
 4,725,734,749.  
 Toptani, Hamid:696.  
 Toptani, Abdi:699  
 Topulli, Çerqiz:624.  
 Tamara, Kolë:825.  
 Tempo, Vukmanoviq  
 Svetozar:806,816,840,843,855,856,857,858  
 ,859,860.

Tërpeza, Hysen:846,847,850.  
 Tanushevci, Tefik:846.  
 Tërshana, Mitat:847.  
 Trepshëv, Dobrivoje:836.  
 Tupurkovski, Vasil:937.  
 Trajkovski, B:  
 970,971,972,979,984,986,989,994,995,1001  
 ,1003,1004,1009.

## TH

Thopia, Karl:255,270,271.  
 Thopia, Tanush:254,255,269,349.  
 Thoipia, Andrea:269,270,271.  
 Thopia, Niketa:304,305.  
 Thopia, Gjergj:271.  
 Thaçi, Hashim:965,887.  
 Thaçi, Menduh:996

## U

Ursili, peshkop:135,245.  
 Uroshi, II,  
 Milutin,despot:206,246,248,249,250,251,26  
 1,262,264,265,274,289,300.  
 Uroshi III, despot:180.  
 Uglesha:290.  
 Ulqini, Safet:828.

## V

Virgjili:34,40,31,150.  
 Valensi:109,183.  
 Valenciani:109,183.  
 Vitigi, mbret:156.  
 Vladimiri, Gjon:200.  
 Vasili (Bazili) II: 209.  
 Vermandua, Hugo:218.  
 Vachece, Joan: 233,235.  
 Vuçitërnali, Ibush:758.  
 Vukashini, dinast:277,290.  
 Volaterrius, peshkop:334.  
 Valestinlis, Rigas:420.  
 Vuksqani, Bajram:430.  
 Vrioni, Iliaz:699.

Vrioni, Ali Mehmet: 444,447,471,815.  
Vlora, Mustafa Nuhi:447.  
Vajks, von marshall:822.  
Vuçaj, Pjertër:826  
Vlora, Sulejman be:674.  
Vlora, Syrja bejh:654.  
Vrioni, Aziz,pasha: 654,674.  
Vokshi, Sulejman: 455,456,589.  
Vokshi, Sabrije:804.  
Vokshi, Beqir:744.  
Vrioni, Muslim:471.  
Vilhelmi, II:551.  
Vllasami, Sejfi:556.  
Veqilharxhi, Naum:590,591,602,608.  
Veshoviq, gjeneral:754.  
Voca, Sherif Beqir:729,794.  
Vidi, princ, Vilhelm:745.

## **W**

Willson,Wudrov (Vilson):738,744.  
Wolfbeck:789.

## **Z**

Zeusi:19,34,45,56.  
Zeno:156.  
Zgurra, Dhimitër:242.  
Zade, Musa Shehu:784.  
Zenebishti, Gjon:268,362.  
Zaharija, Koja:279.  
Zaharia, Seke:354.  
Zajmi, Tahir:826,828.  
Zeçar, Milan:806.  
Zigismund,mbret:302,306.  
Zeqani,Mustafë:432.  
Zeka, Haxhi:433,486,491,494.  
Zena, Qerim:794.  
Zogu, Ahmet:817.  
Zija, Qenani:783.  
Zylfiçari, Azem:900.  
Zyberi, Mexhid:846.  
Zajazi, Sheh Mefail:849.

Jusuf BUXHOVI

**MAQEDONIA**

(Nga antika deri te koha jonë)

